

DSSH/ASD
DITËT E STUDIMEVE SHQIPTARE II/2015
albanian studies days / journées d'études albanais

EDICIONI II

UET / 24-26 Prill 2015

Konferencë ndërkombëtare shkencore / International scientific conference

**"TRANSFORMIMI I MADH: 25 VJET PËRVOJA
SHQIPTARE E TRANZICIONIT DHE DEMOKRATIZIMIT"**

PROCEEDINGS

Tiranë, qershor 2015



Titulli i librit: **TRANSFORMIMI I MADH: 25 VJET PËRVOJA SHQIPTARE E TRANZICIONIT DHE DEMOKRATIZIMIT. International Scientific Conference. Ditët e Studimeve Shqiptare II / 2015. Albanian studies days / Journées d'études albanais.**

Autori: Universiteti European i Tiranës

Redaktore: Marsilda **NDINI**

Art grafik: Besnik **FRASHNI**

Libri është pjesë e kolanës **"ACTA SCIENTIARUM"**.

© 2015 UET Press. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 9380, dt. 28.04.2005 i Shtetit Shqiptar

"Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të", nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë a mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet web apo sisteme të tjerë, pa lejen me shkrim të botuesit.

Universiteti European i Tiranës

Shtëpia Botuese Universitare "UET Press"

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.70, H.1, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri.

uetpress@uet.edu.al

www.uet.edu.al/uetpress

Botimet UET Press certifikohen pranë Zyrës Shqiptare për Mbrojtjen e të Drejtave të Autorit.

International Standard Book Number (ISBN) 978-9928-190-43-7

Libri është kataloguar në datën e publikimit pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës së Universitetit European të Tiranës.



Shtëpia Botuese Universitare
"UET Press" është pjesë e
Universitetit European të Tiranës.

Tiranë, qershor
2015

DSSH/ASD
DITËT E STUDIMEVE SHQIPTARE II/2015
albanian studies days / journées d'études albanais

EDICIONI II

UET / 24-26 Prill 2015

Konferencë ndërkombëtare shkencore / International scientific conference

**"TRANSFORMIMI I MADH: 25 VJET PËRVOJA
SHQIPTARE E TRANZICIONIT DHE DEMOKRATIZIMIT"**

Programi

Konferencë ndërkombëtare shkencore:

“TRANSFORMIMI I MADH: 25 vjet përvoja shqiptare e tranzicionit dhe demokratizimit” **23 PRILL** Pritja e lektorëve të huaj

24 PRILL Ora 18:00 Hapja e konferencës, përshëndetjet e drejtuesëve dhe të ftuarëve

25 PRILL Ora 10:00-13:00 Sesioni i parë i konferencave; Ora 14:00-17:00 Sesioni i dytë i konferencave

26 PRILL Drekë falenderimi me organizatorët dhe pjesëmarrësit në Durrës

KOMITETI SHKENCOR I KONFERENCËS:

Prof. Dr. Adrian Civici - Kryetar
Prof. Dr. Tonin Gjuraj, Prof. Dr. Luljeta Minxhozi, Prof. Dr. Përparim Fuga, Prof. Dr. Engjëll Pere, Prof. Dr. Ferit Duka,
Prof. Dr. Romeo Gurakuqi, Prof. Dr. Ksenofon Krisafi, Henri Cili (PhD), Dr. Arbi Agalliu, Prof. Stefano Bianchini,
Prof. Francois Lerin, Prof. Dimitris Goussios

Koordinator Organizativ: Dr. Arbi Agalliu / **Ndihmës Koordinatorë:** Dokt. Besarta Vladi, Dokt. Elona Shehu

seksionet e konferencës

■ Departamenti Financës

“25 vjet financat e tranzicionit shqiptar: Nga arka e kursimeve tek bankat”

Komiteti Shkencor: Prof. Asoc. Dr. Elvin Meka, Prof. Dr. Magdalena Bregasi, Prof. Assoc. Dr. Anilda Bozdo, Mateo Spaho (PhD) /
Sekretaria Organizative: Dr. Ermela Kripa

■ Departamenti Menaxhim & Ekonomiks / Departamenti Informatikës, Matematikës, Statistikës

“Kultura e re e sipërmarrjes”

Komiteti Shkencor: Prof. Dr. Luljeta Minxhozi, Prof. Asoc. Dr. Oltjana Zoto, Prof. Dr. Engjëll Pere,
Prof. Asoc. Dr. Ermira Qosja / Prof. Asoc. Dr. Indrit Baholli, Mimoza Durrësi (PhD), Eniel Ninka, (PhD), Prof. Asoc. Dr. Hysen
Binjaku / Sekretaria Organizative: Dokt. Genti Beqiri dhe Dokt. Avis Andoni

■ Departamenti e Drejtë Private / Departamenti e Drejtë Publike

“Demokracia shqiptare në tranzicion: Përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin europian”

Komiteti Shkencor: Prof. Dr. Ksenofon Krisafi, Prof. Dr. Romeo Gurakuqi, Prof. Asoc. Dr. Migena Leskoviku, Erjona Canaj
(PhD), Juelda Lamçe (PhD) / Sekretaria Organizative: Mirgen Prençi (PhD) dhe Dokt. Blerta Aliu

■ Departamenti i Edukimit

“Transformimi i edukimit në demokraci”

Komiteti Shkencor: Prof. Asoc. Dr. Tomi Treska, Prof. Asoc. Dr. Ylljet Aliçka, PhD. Erika Melonashi / Sekretaria Organizative: Valbona
Nathanaili (Dokt.)

■ Departamenti Shkencat Sociale të Aplikuara / Departamenti Marrëdhënie Publike dhe Komunikimit

“Transformimi i kulturës politike në demokraci: Nga propaganda tek marrëdhëniet publike”

Komiteti Shkencor: Prof. Dr. Ferit Duka, Prof. Dr. Përparim Fuga, Dr. Roland Lami, Prof. Dr. Aleksandër Dhima, Dokt. Jonida
Këllezi, Dr. Belina Budini, Gilman Bakalli (PhD), Elvin Gjevori (PhD) / Sekretaria Organizative: Dokt.
Irena Myzeqari dhe Ervis Iljazaj (PhD)



DSSH / ASD

Fillimi i një tradite për shkencat humane në Shqipëri

Ditët e studimeve shqiptare është një logo e re që UET krijon për të ndër-tuar një ansambël të madh aktivitetesh me karakter shkencor, debatesh dhe idesh në lidhje me prurjet më të mira të studimeve shqiptare në vit.

Tani që po i afrohem dekadës së parë të jetës së tij UET ka grumbulluar një përvojë të çmuar në kërkimin shkencor, në hapjen dhe mbajtjen gjallë të de-batit në Shqipëri në lidhje me ato tema, subjekte e realitete që kanë nevojë të shqyrtohen dhe studiohen shkencërisht në interes të shoqërisë dhe të publi-kut. Pikërisht kjo është arsyeja përse ne e kemi quajtur pikërisht kështu, Ditët e Studimeve Shqiptare, tërësinë e aktiviteteve, konferencave, debateve, tryezave, ekspozitave, promovimit të librave, kolokiumeve, nën një logo të përbashkët.

Ditët e Studimeve Shqiptare do të jetë një aktivitet i përvitshëm që do të zhvillohet çdo fillim maji, gjë që përkon në Shqipëri me fillimin e pranverës dhe me një atmosferë të hareshme në një vend mesdhetar si Shqipëria.

Ditët e Studimeve Shqiptare do të jetë një festival idesh, një panair i paraqitjeve shkencore, një panair i debatit, një vend kontakti i të gjithë studiuesve shqiptarë dhe të huaj, të cilët në një mënyrë apo në një tjetër kanë subjekt të temave të doktoraturave, të diplomave apo të artikujve shkencorë pikërisht Shqipërinë.


Ky aktivitet i destinohet të gjithë atyre shkencëtarëve, kërkuesve, doktorantëve, studentëve, pedagogëve që kanë nevojë të komunikojnë aktivitetin e tyre shkencor, të ndajnë me të tjerët pikëpamjet dhe idetë e tyre, të promovojnë apo të plotësojnë kërkesat e tyre për kualifikimin shkencor.

Ky aktivitet është gjithashtu një zë i fuqishëm në shoqërinë shqiptare për të drejtuar sytë nga universiteti, nga korporata e profesionistëve dhe të shkencës dhe të kërkimit, të cilët mund të ishin të dobishëm për vendimarrësit, për biznesin, për aktorët shoqërorë, për partnerët ndërkombëtare në lidhje me atë se çfarë realitetesh, perspektivash, prognozash, ka për shoqërinë shqiptare, cila është origjina e fenomeneve e atyre që sot ngjasin dhe si mundet që shkenca të bëhet e dobishme për shoqërinë.

Për të gjitha këto arsye ne kemi konceptuar dhe për herë të parë do të venë në jetë Ditët e Studimeve Shqiptare këtë vit, duke shpresuar që idesë sonë do t'i bashkëngjiten më shumë aktorë, partnerë, individë në këtë festival të shkencëtarëve shqiptarë të cilët në një farë mënyre merren me apo kanë në fokusin e studimeve të tyre, studimet shqiptare.



Prof. Dr. Adrian Civici
Presidenti i UET



DSSH / ASD

Udhërrëfyes i shkurtër i Ditëve të Studimeve Shqiptare

PSE DSSH: Ditët e studimeve shqiptare është një tërësi konferencash shkencore ndërkombëtare të ndërtuara me sistemin e “peer review” për të debatuar sipas fushave të ndryshme në lidhje me problematikën e shoqërisë shqiptare, të ekonomisë, të institucioneve juridike, debateve historike, mediave, institucioneve politike, politikave publike apo të zhvillimit të edukimit dhe arsimit, impa-kteve në zhvillimin shqiptar dhe politikave publike.

PJESËMARRËSIT:

Studiuesve të huaj të cilët kanë objekt dhe fokus të studimeve të tyre ose punimeve të tyre doktrale Shqipërinë.

Pedagogëve shqiptarë të cilët punojnë në universitetet perëndimore prej viteve '90 ose më parë, dhe që kanë e vazhdojnë të kenë Shqipërinë si objekt të tyre të studimeve.

Doktorantëve të huaj që kanë një temë të tyre për Shqipërinë

Doktorantëve shqiptarë të cilët ndodhen në universitetet perëndimore, që kanë për temë studimi një temë që lidhet me Shqipërinë apo me rajonin.

Doktorantëve të UET të cilët kanë nevojë të takojnë komunitetin shkencor përkatës.

DSSH është veprimtaria kryesore shkencore e tetë departamenteve të UET, e trupës së saj akademike dhe studentëve më të shkëlqyer të nivelit master shkencor.

KOHA: Aktiviteti do të organizohet çdo fillim muaji maj dhe do të jetë i ndarë në 10 konferenca sipas problematikës dhe departamenteve të cilat i kanë miratuar komunitetet shkencore të konferencës. *(shih programin bashkëngjitur)*

KALENDARI I AKTIVITETEVE: Aktiviteti do të përmbajë gjithashtu një numër aktiviteteve të tjera (shih programin jashtë konferencës), pikërisht me elementë që përbëjnë jetën shkencore dhe produktin shkencor siç janë: promovimi i librave dhe debati për to, dokumentarë, ekspozita foto-grafish apo dokumentarë të cilët ilustrojnë problematikën e studimeve shqiptare.

Mirë se vini në Ditët e Studimeve Shqiptare!

PËRMBAJTJA

“Outsourcing” si mjet për të përmirësuar efikasitetin e procesit të rekrutimit, 1
Ermira Qosja & Arlinda Vasi JELLA

Përshtatja në shqip e pyetësorit të motivimit të shkencave në formën e pyetësorit të motivimit në lëndën e fizikës, 8
Ahmed Fatih Ersoy & Ylljet Aliçka

Integrimi i Shqipërisë në BE; përfitimet dhe penalitetet në aspektin e identitetit kombëtar, 19
Hazbi Lika

Evoluimi i kulturës politike në ballkanin perëndimor pas periudhës komuniste: rastet e Shqipërisë dhe FYROM, 26
Ilir Kalemaj

Njohja e standardeve për mësues nga drejtuesit dhe mësuesit në shkolla, 35
Dr. Aranit Gjipali, Prof. As. Aleks Trushaj, Ilva Lama & Enkelejda Billa

Ndikimet gjuhësore në gjuhën shqipe si pasojë e zhvillimeve globaliste në informim në dy dekadat e fundit, 45
Fatos Shala

Ndikimi i medias elektronike në të lexuarit nga adoleshentët, 52
Flutura Dervishi

The role of parent-child interaction in language acquisition and personality development of young children in monolingual and bilingual families, 61
Mehmet Aslan

Ecuria dhe puna e vlerësimit të mësimdhënësve dhe mbijetesa e gjuhës shqipe në tranzicion, 67
Afërdita Nimani

Tregues të ndërveprimit aktiv në klasë, 74
Robert Gjedia & Florian Kulla

Premisat juridike dhe sociale për arsimimin e komunitetit rom në Republikën e Shqipërisë, 82
Dhurata Turku & Iva Balza

Mirëqenia e nxënësve në shkolla, si një dukuri edukuese, 87
Enkeleda Stefa

Albanian teachers' approaches to classroom management, 94
Nihat Aksu

Përgjigja ndaj shqetësimit, të prindërve: a lidhet autizmi me vaksinën MMR?, 103
Voltisa Lama

Raportimet e prindërve mbi vonesat gjuhësore të fëmijëve me autizëm në 5 vitet e para të jetës, 110
Voltisa Lama & Anisa Ferizi

Mësimi i gjuhës angleze nëpërmjet tregimit, 119
Elona Ziu

Roli, misioni, funksionet dhe përgjegjësitë e mësuesit kujdestar të klasës në sistemin e sotëm të arsimit shqiptar, 130
Lindita Treska & Tomi Treska

Dimensionet e teorive arsimore dhe vlerat në procesin mësimor edukativ, 136
Bashkim Peçi

Ndikimi i marrëdhënies atashuese me nënën në edukimin e sjelljeve eksploruese të fëmijët e moshës 5-6 vjeç, 144
Flora Lamcja (Zeqaj)

Koncepti i pacënueshmërisë dhe sjelljet e rrezikshme për shëndetin tek adoleshentët shqiptarë, 151
Dejla Hoxha & Erika Melonashi

Reagimet e nxënësve gjatë përballjeve me aktivitete inovative në shkollë, 164
Fatmir Agaj

Roli i zhvillimit të vazhdueshëm profesional në kujdesin shëndetësor në Kosovë, 171
Niman Bardhi & Eglantina Kraja

Përforcimi dhe menaxhimi i resurseve njerëzore në institucionet shëndetësore në Kosovë, 182
Eglantina Kraja & Niman Bardhi

Përjetimi i menopauzës tek femrat shqiptare: analizë e faktorëve ndikues, 192
Odeta Cacaj & Erika Melonashi

Motivacioni dhe produktiviteti i organizatës, 202
Luljeta Bexheti

Ndikimi i stilit të jetës te acientët me hipertension arterial në rajonin e Prizrenit, 211
Nderim Rizanaj

Ndërmjetësimi familjar: modelet kryesore të procesit të ndërmjetësimit familjar në kontekstin e kulturës shqiptare, 221
Klodiana Rafti

Paraja elektronike dhe përdorimi i saj në Shqipëri, 227
Kestrina Ramallari

Dinamika e diskursit politik të liderit shqiptar, 239
Ornela Elezi

E drejta për vetëvendosje e shqiptarëve të Kosovës në kohën e shpërbërjes së ish RSFJ-së, 247
Erjona Rama

Transnacionalizmi i vonuar në zhvillimin shoqëror dhe demokratik në ballkan dhe shqipëri, 257
Joniada Barjaba

Qëndrueshmëria e lëvizjes Vetëvendosje në sferën politike, 265
Orges Zani

Demokratizimi nëpërmjet zgjerimit: një studim krahasimor midis Bosnje Hercegovinës dhe Kosovës, 274
Stiliano Rushaj

Vlerësimi i ambjentit të sigurisë në vendet e rajonit, 282
Vilma Spahiu & Përparim Fuga

Fenomeni ISIS - përtej një konflikti të armatosur (dilema të komunikimit social-kulturorë në çështje të sigurisë), 287
Kristaq Xharo & Mimoza Duka

Impakti evropian në politikën shqiptare dhe mekanizmat evropianizuese, 297
Irna Peshkëpia

Përdorimi i statistikave S² dhe C në procesin e kontrollit të cilësisë së prodhimit, 302
Teuta Xhindi

Testime, studime dhe raporte të “rumbullakosur” nuk e shërojnë arsimin, vetëm se i zgjatin agoninë, 308
Hysen Binjaku

Mbi debatin dhe shpërndarjen e ideve neoliberalë në Europën Lindore, 317
Besart Kadia

Tranzitologjia: një kritikë anti-teleologjike, 322
Gerti Sqapi

Pasojat e komunizmit në kulturën politike shqiptare, 328
Ina K. Zhupa

Transformi i pushtetit në shoqërinë moderne, 333
Klementin Mile

Roli i orientalizmit në modernitetin shqiptar, 337
Lulzim Hoxha

Ndryshimet dhe vazhdimësitë në ligjërimin politik të liderëve shqiptarë ndaj Kosovës, 342
Dorina Ndoj

Analizë e sigurisë energjetike në Shqipëri nëpërmjet një qasje multidimensionale, 348
Fatri Morina & Përparim Fuga

Aplikimi i dënimit penal me gjobë në Shqipëri. Vështrim teoriko-praktik, 351
Aleks Nikolli

Garancitë kushtetuese në Republikën e Shqipërisë: aspekte krahasuese, 359
Ana Dhamo

Legjislacioni mjedisor. Ligji për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, dhe Kushtetuta, 364
Artan Manushaqe & Eugena Bisha

Përgjegjësia e shtetit për dëmin në Republikën e Kosovës, 373
Artan Qerkini

Format e manifestimit të krimit të organizuar, 378
Besim Arifi

Përafrimi i legjislacioni penal shqiptar me atë të Bashkimit Evropian, 382
Elena Xhina

Drejtësia në Kosovë përballë sfidave 16-vjeçare të sistemit paralel të Serbisë, 387
Haki Kabashi

Disa nga reformat legjislative për përshpejtimin e integritetit të Shqipërisë në BE, 397
Irisi Menga

Impakti që solli krijimi i monedhës së përbashkët euro në lëvizjen e lirë të kapitalit në BE, 401
Majlinda Tafaj

- Veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës, në periudhën e zhvillimeve tranzitore demokratike shqiptare dhe perspektiva evropiane, 408**
Marilda Menkshi & Medi Bici
- Të drejtat e njeriut dhe evoluimi i sovranitetit të shtetit, 412**
Petrit Nimani
- Ushtrimi i sovranitetit shtetëror dhe prezenca e organizatave ndërkombëtare me kompetenca ekzekutive në Republikën e Kosovës, 422**
Samedin Mehmeti
- Barazia gjinore në punë në të drejtën evropiane, 430**
Skerdilajd Bajramaj
- Afatet procedurale të gjykimit kushtetuese në kontrollin abstrakt ndaj akteve normative me fuqinë e ligjit të këshillit të ministrave, 437**
Gerti Shella
- Mbikqyrja elektronike sipas legjislacionit shqiptar, 444**
Mirgen Prençe & Ervis Iljazaj
- Paraqitjet e shqipërisë së tranzicionit për audiencat perëndimore, 450**
Belina Budini
- Wireless sensor networks for air pollution monitoring, 454**
Mimoza Durrësi & Luciana Kini
- Distributed wireless sensor networks for saving the fauna in lakes, 460**
Mimoza Durrësi
- Ndikimi i sistemeve të informacionit në sipërmarrje, 464**
Idaver Sherifi
- Huat me probleme: zgjidhje përtej kontekstit tradicional, 472**
Elvin Meka
- Tregjet e sigurimeve bujqësore – mësim nga vendet e zhvilluara dhe emergjente për realitetin shqiptar, 481**
Magdalena Bregasi
- Matja e performancës së bankave tregtare në Shqipëri nëpërmjet analizës së raporteve financiare, 491**
Ermela Kripa & Arbi Agalliu
- Menaxhimi i rreziqeve financiare kusht për rritjen e përfitueshmërisë në bankat tregtare në Shqipëri, 498**
Anilda Bozdo & Sokol Ndoka
- Transmetimi i normës bazë së interesit tek produktet bankare në Shqipëri, 510**
Edi Mala
- Motivimi drejt vendimarrjes etike: rasti i kontabilistëve shqiptar, 519**
Loreta Bebi & Brunilda Llaftiu
- SKK dhe roli i tyre në transformimet e financave të bizneseve, 528**
Klodian Bllaci & Magdalena Bregasi
- Kënaqësia e klientit në bankat tregtare që operojnë në Shqipëri, 538**
Jasmina Lumanaj & Drita Kruja
- Kontrolli doganor i bazuar në auditim – krahasimi i standartit 6.6 Dhe 6.10 nga konventa e rishikuar e Kyotos me aspektin ligjor dhe praktikat e kontrollit pas importuese nga Dogana e Kosovës, 547**
Mentor Gashi
- Small government or big government?, 555**
Mateo Spaho
- Zhvillimi i sistemit informativ gjeografik GIS dhe impakti i tij në zbulimin e botës, 562**
Afërdita Çekaj- Thaçi
- Marrëveshjet e tregtisë së lirë drejt liberalizimit të tregtisë, 568**
Ardita Seknaj
- Analiza e performancës së Bankës Kombëtare Tregtare nëpërmjet analizës financiare, 578**
Anilda Bozdo & Ermela Kripa
- Roli i familjes në edukimin shëndetësor të Adolehentit, 588**
Dritan Ceka
- E drejta e pronësisë, si një nga të drejtat themelore kushtetuese. Mbrojtja juridiko-ligjore e saj. Rasti i Shqipërisë, 597**
Sofiana Veliu
- Efektiviteti i relaksimit progresiv në reduktimin e ankthit në një kampion jo-klinik, 604**
Fleura Shkëmbi, Erika Melonashi & Naim Fanaj
- Identifikimi i faktorëve të suksesit në kooperimin ndërorganizacional dhe në ndërmarrjen virtuale, 610**
Erind Hoti
- Internet banking në Shqipëri. Përshtatja me rregullat evropiane dhe sfidat e realitetit shqiptar, 619**
Erjona Canaj

Rregullimi kontraktor i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, 626

Xhensila Kadi

Rruga e Shqipërisë drejt tregut të përbashkët evropian. Lëvizja e lirë e shërbimeve, 631

Sokol Bana

Aplikimi i menaxhimit strategjik në ekonominë të zhvillim, tregu i Shqipërisë dhe Kosovës, 637

Rrezarta Gashi

Evidence of gender discrimination in wages earned in Albania through the use of LFS data, 649

Enton Duro & Merita Cani

Shërbimi civil shqiptar dhe risitë e ligjit të ri “Për Nëpunësin Civil”, 655

Migena Leskoviku

Histori e së drejtës civile në Shqipëri, 659

Çlirim Duro

Historia e së drejtës penale në Shqipëri, 664

Çlirim Duro

Ndikimi i audiencës në platformat tradicionale në Shqipëri, 670

Fatos Salliu

Integrimi i institucioneve paralele gjyqësore të veriut të Kosovës, realitet kushtetues apo integrim mbikushtetues, 680

Rafet Haxhaj

Demokratizimi i Kushtetutës shqiptare konform standarteve europiane, 684

Irisi Topalli

Funksionimi i programit për zhvillim profesional të mësimdhënësve në Kosovë (Përshkrim i gjendjes për një periudhë të funksionimit të programit), 689

Arbërore Berisha – Bicaj

E drejta e jetës “një analizë e dinamikave të kësaj të drejte”, 694

Aferdita Tepshi

Roli i ndërmjetësimit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare në kuadër të OKB dhe BE, 701

Jonida Mehmetaj

Ekonomia e Kosovës dhe e Shqipërisë gjatë krizës globale financiare, 709

Jeta Nushi

Procesi administrativ në Shqipëri, 720

Pranvera Xhafaj

Analiza e nevojave të bankave për gjuhë angleze dhe komunikim, 725

Elsa Zela

The Presence of Albanian Women in Politics; An Empirical Investigation, 734

Dilina Beshiri & Edi Puka

Sistemi mediatik shqiptar dhe roli i tij në konsolidimin e demokracisë, 741

Lorena Liçenji

Menaxhimi i kohës në organizatat publike – rasti i administratës tatimore të Kosovës, 747

Shefqet Dervishaj

Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit. Një rast studimor krahasimor, 755

Denisa Mamillo

Ndikikimi i kulturës kombëtare në nivelin e bashkëpunimit në zinxhirin e furnizimit, 760

Denisa Mamillo & Oltjana Zoto

Përgjegjësia sociale e ndërmarrjeve prodhuese në Komunën e Pejës, 765

Sylë Kolica

Gjerimi i punëve të tjetrit në Kodin Civil Shqiptar. Praktika gjyqësore shqiptare. Vështrim krahasues, 771

Endira Bushati

Analizë e konkurrueshmërisë së sistemit bankar në Shqipëri sipas madhësisë së bankave, 780

Eugen Musta & Elona Shehu

Respektimi i parimit të interesit më të lartë të fëmijës në legjislacionin vendas dhe ndërvendas në procesin e birësimit, 790

Shkëndi Çili

Investimet e huaja direkte në Shqipëri, 799

Enis Uruçi

Vështrime krahasuese të Rregullores së Këshillit Europian “Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”, 803

Andja Levanaku

Audienca e reja, ndryshimi i raportit me procesin e prodhimit dhe konsumimit të lajmit, 809

Erlis Çela

A ka realisht një ndryshim mes Propagandës dhe PR-it në vendet me stabilitet politik delikat siç është Kosova?, 816

Njomza Krasniqi

Rëndësia e burimeve njerëzore për realizimin e strategjisë së firmës, 824

Qemajl Sejdiqja

Shqipëria, Stalini, Hrushovi, thyerja e marrëdhënieve dhe ritakimi diplomatik në vitin 1990, 834

Juljana Krisafi

Roli garantues I gjyqtarit për hetimet paraprake, 846-851

Andi Dura

Politika fiskale dhe tatimore gjatë viteve të tranzicionit në Kosovë, 838

Naim Gashi

Strategjia për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në rajonin perëndimor të Kosovës, 839

Ardian Berisha

Si ndikon sistemi elektorale në rezultatet e zgjedhjeve politike!, 845

Aurora Balukja

“OUTSOURCING” SI MJET PËR TË PËRMIRËSUAR EFIKASITETIN E PROCESIT TË REKRUTIMIT

PROF. ASOC. DR. ERMIRA QOSJA

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti Ekonomik, ermira.qosja@uet.edu.al

ARLINDA VASI JELLA

Master Profesional, Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti Ekonomik

ABSTRAKT

Rekrutimi i burimeve njerëzore nëpërmjet një firme rekrutimi ose outsourcing është sot një strategji e rëndësishme e përdorur nga shumë organizata në nivel global, e cila ndihmon për të reduktuar koston dhe kohën e rekrutimit, por mbi të gjitha për të përmirësuar cilësinë e procesit të rekrutimit.

Prej disa vitesh firmat e rekrutimit janë duke zhvilluar aktivitetin e tyre dhe në Shqipëri, fillimisht janë përdorur si praktikë e disa kompanive të huaja shumëkombëshe dhe më pas, nga kompanitë e mëdha shqiptare të biznesit.

Punimi synon të vlerësojë në se outsourcing përmirëson efikasitetin e procesit të rekrutimit dhe për këtë, është bazuar në studimet e literaturës, si dhe është zhvilluar një kërkim primar mbi pesë kompani që përdorin firma rekrutimi (outsourcing) Gjetjet e studimit tregojnë se jo vetëm efikasiteti i procesit të rekrutimit përmirësohet, por dhe se procesi i rekrutimit nëpërmjet firmave të rekrutimit do të njohë rritje në të ardhmen në Shqipëri.

Fjalë kyç: *Burimet Njerëzore, rekrutimi, kontraktimi i rekrutimit, organizatat, kompanitë*

1. Hyrje

Organizatat janë duke kërkuar dhe vlerësuar se ku mund të gjejnë punonjës më të kualifikuar, për të shtuar vlerën e produkteve të tyre (Taplin, R, 2008). Organizatat gjithnjë e më shumë po besojnë tek delegimi i procesit të rekrutimit ose “outsourcing”, sepse sigurimi i njerëzve të duhur është një faktor suksesi për biznesin e tyre (Seth.M, & Sethi.D, 2011; fq.2), dhe outsourcing mund ta bëjë më të prekshme këtë mundësi.

Termi ndërkombëtar “outsourcing” i referohet kontraktimit të një pale të tretë, për të kryer shërbime të caktuara ndaj organizatës, nëpërmjet një marrëveshjeje kontraktuale. Në funksionin e burimeve njerëzore, outsourcing mund të përfshijë përgjegjësinë për menaxhimin e personelit ose vetëm procesin e rekrutimit të punonjësve. Delegimi i procesit të rekrutimit të punonjësve është një proces relativisht i ri, i cili po bëhet shumë popullor në organizatat moderne, i përdorur kryesisht për rritjen e efikasitetit të organizatës nëpërmjet menaxhimit të kohës, së bashku me uljen e kostos së procesit (Jamil, R. & Naeem. H, 2013; fq.69).

Rritja e përdorimit të kontraktimit të burimeve të jashtme gjatë viteve të fundit ka ardhur dhe si rezultat i një ndryshimi në filozofinë e biznesit. Një kontraktim i suksesshëm i burimeve të jashtme për burimet njerëzore kërkon një kuptim të plotë dhe të qartë të aftësive dhe vendimeve të ardhshme të biznesit.

Ashtu siç William R.King ka shpjeguar në “Information Systems Management» vendimet në lidhje me outsourcing e funksioneve të rëndësishme janë ndër më strategjikët që mund të merren nga një organizatë, sepse ato trajtojnë zgjedhjen organizative të funksioneve për të cilat zhvillohet ekspertiza e brendshme dhe ato, për të cilat nënkontraktohet një ekspertizë e tillë.” (Despoti. M, 2007).

Tashmë organizatat dhe studjuesit janë duke hulumtuar rreth pyetjes: “A duhet që aktivitetet e MBNJ të vazhdojnë të sigurohen brenda organizatës apo duhet që një pjesë ose të gjitha këto aktivitete t’i jepen tek një kontraktori të jashtëm?” (Kosnik.T, Wong-MingJi.D, Green.G; 2004; fq.671). Ndërsa studimet vazhdojnë, shumë organizata janë duke eksperimentuar me kombinime të ndryshme të aktiviteteve të burimeve njerëzore, duke përfshirë edhe dhënien e gjithë funksioneve të burimeve njerëzore një kontraktori të jashtëm (Klaas et al, 1998;).¹

Punimi i mëposhtëm trajton fenomenin e procesit të rekrutimit të punonjësve nëpërmjet kontraktorit të jashtëm të rekrutimit. Për këtë punim janë shfrytëzuar të dhënat e deritanishme të literaturës së huaj dhe dhe përvoja e disa kompanive private në Shqipëri.

Punimi përqipet të krahasojë rekrutimin e punonjësve nga departamenti i burimeve njerëzore të kompanisë me atë të dhënies së këtij procesi një firme kontraktore rekrutimi. Në punim theksohen avantazhet e procesit të rekrutimit të kryer nga firmat kontraktore të rekrutimit në krahasim me atë të kryer brenda organizatës, duke marrë në shqyrtim disa kompani vendase që përdorin të dyja format e rekrutimit. Në mbyllje janë dhënë përfundime dhe konkluzione të nxjerra nga shqyrtimi i literaturës dhe punimi i kryer dhe i paraqitur.

Qëllimi i këtij punimi është «*Të vlerësojë alternativat e procesit të rekrutimit duke analizuar faktorët që e bëjnë kontraktimin e rekrutimit një strategji më efektive për kompanitë që e përdorin atë*».

Pyetja kërkimore: «*A është kontraktimi i rekrutimit më efikas se procesi i kryer brenda organizatës?*» dhe hipotezë bazë është: *Kontraktimi i rekrutimit është një proces më efikas se procesi i kryer nga vetë organizata, për pozicione dhe ekspertizë specifike*» Për të realizuar këtë punim fillimisht është përdorur *metoda e analizës cilësore*.

2. Rishikimi i literaturës

Funksioni i menaxhimit të burimeve njerëzore (MBNJ) është pjesë strukturore e një organizate, qëllimi i të cilit është të projektojë dhe të maksimizojë performancën e punonjësve në shërbim të objektivave strategjike të punëdhënësit të tyre (Johnason, P, 2009; fq.19).

Departamenti i burimeve njerëzore në një organizatë është përgjegjës për rekrutimin, trajnimin e zhvillimin, vlerësimin e performancës së punonjësve (Pauwer,J. & Boon, C; 2009: fq.38), si dhe për balancimin e praktikave organizative me rregullat që dalin nga negociatat kolektive dhe ligjet qeveritare (Klerck, G; 2009: fq.238)

Në mjedisin e sotëm të punës globale, të gjitha kompanitë botërore janë fokusuar në mbajtjen e specialistëve dhe të fuqisë punëtore të specializuar, në uljen e qarkullimit të punonjësve dhe ruajtjen e punonjësve me njohuri të larta të procesit të punës, për arsye se punonjësit e rinj, jo vetëm që kërkojnë një kosto të lartë, por edhe rrisin rrezikun e mos zëvendësimit me personin e duhur (Merkle, Judith A; 1980).

Këshillimi në burime njerëzore është një profesion i lidhur me këshillimin në karrierë për organizatat, që në vitin 2007 numëronte 950 konsulentë të burimeve njerëzore në nivel global, duke përbërë një treg 18.4 miliardë USD (Workforce Management 2007, www.workforce.com). Për vitin 2010, konsulenca në burime njerëzore u rendit në vendin e 43 si puna më të mirë në Sh.B.A. nga CNN Money (CNN Money, “HR consultant” 2011, <http://money.time.com>).

Në mënyrë tipike, një kontraktor për shërbime rekrutimi është i aftë për një konsulencë të specializuar në rekrutime në organizatat e mëdha duke filluar nga këshillimet strategjike dhe deri në ofrimin e specialistëve për proceset e punës në një kompani. Hulumtimet tregojnë se punëdhënësit me përvojë kanë tendencë për të përmirësuar (Darling.P, 2007) procesin e

– Për më tepër informacion mund të shihni: Kosnik.T, Wong-MingJi.D, Green.G (2004). Outsourcing vs insourcing in the human resource supply chain: a comparison of five generic models, fq.671-689 <http://www.visusgroup.com/articles/outsourcing.pdf>.0

rekrutimit duke marrë vendimet e punësimit nëpërmjet outsourcing, sepse janë më pak të ndikuar nga perceptimi i çastit ndaj aplikantit.

Nga përdorimi i outsourcing organizata merr këto avantazhe: bën të mundur që biznesi të përqendrohet në aktivitetet bazë të tij; lehtëson drejtimin e operacioneve të organizatës; jep mundësi aksesit tek aftësitë/njohuritë profesionale; zvogëlon rrezikun; sigurohet se procesi është "në duar të sigurta"; lehtësohet futja e teknologjive të reja; përmirësohet cilësinë e shërbimeve; më pak ngarkesë për burimet njerëzore; kontroll më i mirë i organizatës; fleksibilitet më i madh i saj (Despoti, M, 2007).

Në se do të flisnim për disavantazhet e outsourcing, Birtch et al (2010) dhe Gurney et al (2009) pohojnë se funksionet e ndjeshme të BNJ dhe që kanë rëndësi strategjike duhet të mbahen brenda firmës, ndërkohë Greer et al (1999) e konsiderojnë procesin e punësimit dhe të vlerësimit të punës, si aktivitete bazike në organizatë. Sipas tyre nuk mund të ketë zgjidhje pragmatiste në këtë rast e kjo lidhet me natyrën e veçantë të menaxhimit të këtyre aktiviteteve, sepse për të qenë efektive duhet "sigurimi i besimit, qëndrueshmërisë dhe të kuptuarit afatgjatë të efekteve në marrëdhëniet dhe kontrollin e informacionit të fshehtë" (Greer et al, 1999).

Gilley et.al (2004) theksojnë se delegimi i aktiviteteve të rekrutimit nuk ndikon në përmirësimin e performancës financiare në afatshkurtër dhe se kostoja e nënkontraktimit është shpesh më e lartë se ajo e parashikuar ose se ajo e rekrutimit nga brenda.

Delegimi i rekrutimit mund të konsiderohet dhe si një aspekt i kompetencave thelbësore të humbura nga vetë organizata (Gurney et al, 2009) theksojnë se me delegimin e rekrutimit humbet ekspertiza e brendshme në "kujtesën e korporatave", sepse firmës së rekrutimit i mungon njohuria e mjaftueshme në lidhje me kulturën organizative dhe praktikën e kaluara Humbja e ekspertizës dhe aftësive mund të kenë një ndikim negativ në konkurrencë, rrit varësinë nga jashtë dhe zvogëlon aftësinë për të mbajtur bashkëpunimin e brendshëm dhe kreativitetin (Belcourt, 2006).

Delegimi i rekrutimit mund të pengojë zhvillimin e karrierës, pasi kufizon punonjësit për mundësinë e fitimit të ekspertizës nëpërmjet një gamë të gjerë të aktiviteteve, në linjë me organizimin e brendshëm të organizatës (Greer et al, 1999).

Delegimi i aktivitetit të rekrutimit të burimeve njerëzore pohohet shpesh që pengon fleksibilitetin në lidhje me vendimet strategjike, sepse organizata mund të vendoset në pozicionin ku nuk mund t'i përgjigjet nevojave organizative për shkak të kontrollit të humbur mbi aktivitetin e rekrutimit (Lepak & Snell, 1998) e kufizuar kjo marrëveshjet e nënshkruara.

Cooke et al (2005) shprehen që cilësia e shërbimit të ofruar nga rekrutuesi i jashtëm është e pakënaqshme për shkak të mungesës së vazhdimësisë së shërbimit dhe për rrjedhojë në performancë më të ulët organizative .

Bazuar në sa më lart, për kompanitë e mëdha është më e favorshme që procesi i rekrutimit të bëhet me outsourcing. Kështu, të gjitha procedurat e rekrutimit si njoftimi, selektimi i aplikimeve, shqyrtimi dhe përzgjedhja e dhjetra apo qindra kandidatëve, intervistat deri tek zgjedhja dhe përfundimi i rekrutimit të cilat kërkojnë kohë të konsiderueshme dhe njerëz, mund të shmangen nëse me këtë proces merret një kontraktor i jashtëm. Në këtë mënyrë burimet njerëzore mund të kenë kohë për t'u marrë me çështje të tjera, për të rritur efikasitetin e produktivitetin e fuqisë punëtore dhe efikasitetin e organizatës.

Kontraktimi i rekrutimit është mjaft i dobishëm kur krijohen mjaft pozicione të reja apo kur duhen shtuar departamente apo hapen linja të reja të biznesit. Shërbimet e kontraktimit e bëjnë në këto raste me të shpejtë dhe më të lirë procesin e rekrutimit, se kur kryhet nga vetë organizata. (Greenberg, A, 2013).

Vlera e vërtetë e procesit të rekrutimit me nënkontraktim është kur integrohet hap pas hapi dhe bëhet pjesë organike e organizatave të cilave u shërben. Kontraktimi i procesit të rekrutimit mund të sigurojë kandidatë, shërbime dhe ekspertizë në rekrutim, duke i bërë të mundur organizatës të konkurrojë në një gamë më të gjerë aktiviteteve dhe të punësojë punonjës mjaft cilësorë (Greenberg, A, 2013).

Nga literatura shihet se ka qëndrime të ndryshme në lidhje me outsourcing e burimeve njerëzore, disa janë pro dhe disa kundër, paraqitja rreth të dhënave nga literatura për procesin e rekrutimit me outsourcing e bën më të qartë qëllimin dhe nevojën e këtij studimi.

Studjuesit kanë identifikuar faktorët që mund të ndihmojnë organizatat për të përcaktuar se cilat procese të BNJ duhet të transferojnë dhe cilat duhet të mbajnë. Literatura thekson se shkuarja drejt outsourcing në burime njerëzore lidhen me uljen e kostove për kompaninë (Seth. M & Sethi.D, 2011; fq.2), rritjen e fleksibilitetit të fuqisë punëtore, përqëndrimin në burimet menaxheriale dhe mbajtjen në funksionim të plotë rregulloret e punës (Klaas et al, 1998).

Probleme të rëndësishme mund të dalin, si: mungesa e përgatitjes së punonjësve, cilësia e shërbimit të kontraktorit të burimeve njerëzore dhe mungesa e kompetencave për të menaxhuar marrëdhënien me firmën e outsourcing.

Lawler&Mohrman (2003) në një studim prej 150 kompanive evidentuan se problemet më të zakonshme të outsourcing të BNJ ishin shërbimi i dobët, kosto më e lartë se ajo e pritur, kontraktuesit ishin me njohuri të pamjaftueshme në lidhje me klientin dhe burime të papritura të kërkuara për të menaxhuar marrëdhëniet.

Kosnik et al (2004) përshkruan disa rreziqe si vijon:²

- ← Organizatat janë të frikësuara për humbjen e kontrollit mbi ofrimin e shërbimeve dhe e shikojnë veten tepër të varur nga kontraktori.
- ← Informacioni konfidencial vihet në rrezik nëse siguria e informacionit nuk mbahet e tillë nga kontraktori.
- ← Paaftësia e menaxhimit të outsourcing mund të çojë në rritjen e kostove.

← Për informacion më të detajuar shih Kosnik, T, Wong-Ming, J. D, Green, G (2004). Outsourcing vs insourcing in the human resource supply chain: a comparison of five generic models, fq.671-689 <http://www.visusgroup.com/articles/outsourcing.pdf>

Duke pasur parasysh efektin e gjerë të funksionit të BNP brenda një organizate, të kuptuarit e ndikimit të vendimit për outsourcing është kritike për menaxherët që dëshirojnë për të përmirësuar performancën e kompanisë dhe ndikimin në kapitalin e saj (Butler G.M, Carolyn M. & Callahan B, 2012; fq.2).

Menaxhimi i punonjësve në organizatë në mënyrë efektive dhe strategjike mund të rrisë vlerën e aksioneve nga 10 deri në 20%, të çojë në uljet e kostos (Hansen, 2008) dhe si rezultat të sjellë në përmirësimin e performancës së firmës.

3. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Ky punim ka si qëllim «Të vlerësojë alternativat e procesit të rekrutimit duke analizuar faktorët që e bëjnë kontraktimin e rekrutimit një strategji më efektive për kompanitë që e përdorin atë».

Objektivi i parë ka të bëjë me njohjen e literaturës mbi outsourcing e procesit të rekrutimit të burimeve njerëzore, objektivi i dytë është të qartësojë arsyet për të cilat outsourcing është më efikas se rekrutimi i kryer nga vetë organizata, objektivi i tretë është që përfundimet e punimit të nxjerra nga kërkimi primar mbi një numër të kufizuar organizatash biznesi të shërbejnë si rekomandim për bizneset dhe organizatat e tjera.

4. Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Për të përmbushur qëllimin e këtij punimi, është shtruar *pyetja kërkimore* e mëposhtme: “A është kontraktimi i rekrutimit më efikas se procesi i kryer brenda organizatës?” dhe dy pyetje ndihmëse:

- ← A po rritet përdorimi i firma të specializuara rekrutimi (head-hunting) në procesin e rekrutimit nga kompanitë shqiptare?
- ← Për cilat pozicione është më efikas kontraktimi i rekrutimit?

Hipotezë bazë e këtij punimi është: *Kontraktimi i rekrutimit është një proces më efikas se procesi i kryer nga vetë organizata, për pozicione dhe ekspertizë specifike»*

Për të realizuar këtë punim fillimisht është përdorur metoda e analizës cilësore. Mbledhja e të dhënave është bërë nëpërmjet një pyetësi të strukturuar me 13 pyetje si dhe intervista gjysëm të strukturuar. Në shqyrtim janë marrë 5 kompani që zhvillojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri: Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, Vodafone Albania, Credins Bank, Intesa San Paolo dhe Devoll Hydropower.

Kufizimi i parë i këtij punimi është numri i vogël i kompanive të marrë në shqyrtim, gjithashtu studimi i efekteve të outsourcing kërkon shtrirje kohore për të matur përmirësimin e performancës së organizatës, si dhe mund të ishin përfshirë edhe disa variabla të tjera, që lidhen me shpërndarjen e kompetencave të burimeve njerëzore me firmën e rekrutimit gjatë procesit të rekrutimit

5. Analizë, interpretim të dhënash

Fillimisht po japim disa të dhëna të natyrës përshkuese të organizatave të marra në shqyrtim. Të pesë organizatat janë të mëdha, katër prej tyre gëzojnë statusin juridik të shoqërisë aksionere, ndërsa Aeroporti Nënë Tereza është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Për shkak të pozicionit në treg, strukturës juridike e numrit të punonjësve, organizatat e marra në shqyrtim kanë një departament të burimeve njerëzore, i cili përveç të tjerave, kryen edhe procesin e rekrutimit për një pjesë të pozicioneve.

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, Procredit Bank, Vodafone Albania, Intesa San Paolo dhe Devoll Hydropower përdorin firma rekrutimi për pozicionet vakante në kompanitë e tyre. Por nga komunikimi i bërë me kompanitë e rekrutimit si: ISNA Consulting & Coaching, Dinamycs Partners, Dr. Pendl & Pisanger, Pedersen & Partnes dhe EJ Business Consulting mundëm të gjenim informacion që dhe kompani të tjera si Bechtel-Enka, Ernst & Young, TDG Europe, Eurovini, Coca-Cola, Casa Italia, Porsche Albania, Raiffeisen Bank, etj në disa prej pozicioneve i drejtohen nënkontraktimit.

Arsyet e përzgjedhjes së një firme rekrutimi shprehen kompanitë e marra në shqyrtim, lidhen me imazhin e saj në treg, me rezultatet ndaj kompanive të kontraktuara, si dhe me specifikat e kërkesave të tyre në tregun e punës. (rastit Devoll Hydropower Sh.A dhe Aeroporti “Nënë Tereza”).

Pyetjes mbi formën e bashkëpunimit: specifik apo i vazhdueshëm dhe afatgjatë (Kosnik.T, Wong-Mingi.D, Green.G (2004; fq.675) kompanitë i janë përgjigjur specifik, përveç Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës që bashkëpunon në formë afatgjatë me firmën e rekrutimit, kompanitë e tjera këtë formë nuk e gjejnë të nevojshme.

Përzgjedhja e niveleve menaxheriale sipas Scott D. Stewart (2013) nga Instituti CFA³ në është një hap kritik për organizatën. Pyetjes se “Cilat pozicione plotësohen nëpërmjet firmës së rekrutimit?, përgjigjet ishte nivelet e mesme dhe

← Instituti CFA është shoqata më e madhe e profesionistëve të investimeve në botë. Për më shumë informacioni vizitoni faqen zyrtare elektronike <http://www.cfainstitute.org>

të ulta menaxheriale, ndërkohë për nivelin e shefit ekzekutiv zgjidhja vjen ose nga kompanitë mëmë ose kushtëzohet nga pronësia, ndërkohë për nivelet e specialistit procesi bëhet nga departamenti i BNJ.

Procesi i rekrutimit në organizata është komplekse dhe merr kohë të gjatë. Koha e rekrutimit të punonjësve ka probleme edhe në organizatat më të mëdha ndërkombëtare, por njëkohësisht ka edhe rrugë dhe mënyra për ta përmirësuar atë.

Në kompanitë e marra në shqyrtim, koha mesatare për të përfunduar të gjithë procesin e rekrutimit është afërsisht 1-2 muaj, më përjashtim të Vodafone Albania që e ka deri në 1 muaj.

Organizatave mund të përdorin disa ose të gjitha njësitet matëse për të vlerësuar një firmë rekrutimi në varësi të nevojave të tyre dhe strategjive të tyre të rekrutimit, por ato më të zakonshmet përfshijnë: vëllimin e kandidatëve, koston e rekrutimit, kohën e përbushjes së rekrutimit, cilësinë e rekrutimit, kohën e qëndrimit të kandidatit në organizatë, performancën e kandidatit gjatë qëndrimit në organizatë (Raju, M; 2013).

Kompanitë në punim treguan se vlerësonin më shumë kohën e përfundimit të procesit, më pas vinte performanca e kandidatit të rekrutuar, ku në të shumtën e rasteve pritej në fakt sa e lartë do të ishte, për arsye se kishin një përvojë bashkëpunimi me firmën e rekrutimit dhe në një mënyrë ishte krijuar një lloj besimi në parim. Variablat e tjera si kostoja e rekrutimit për çdo punësim, ishin të detajuara në kontratën dypalëshe të bashkëpunimi. Ndërsa, variabli "koha e propozimit të kandidatit të parë" nuk kishte interes, sepse firmat e rekrutimit raportojnë në mënyrë të detajuar përse kishin zgjedhur kandidatin e caktuar, në mes të disa kandidatëve të tjerë dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit jepte aprovimi ose kundërshtimin nga kompania punëdhënëse.

Pagesat për procesin e rekrutimit për firme kontraktuese, sipas literaturës, varen nga marrëveshjet, por kryesisht paguhen me (1) tarifë fikse mujore për shërbimet e tyre, (2) në bazë të çdo personi të punësuar dhe nivelit të punësimit, dhe (3) në bazë përqindje kryesisht në bazë të performancës së kandidatit të rekrutuar; zakonisht 15% - 25% të pagës vjetore të punonjësit të rekrutuar (Sundheim, K. 2013).

Kompanitë e përfshira në studim (përveç Aeroportit) raportojnë se forma e bashkëpunimit është sipas nevojave specifike, në këtë rast pagesa e firmave të rekrutimit bëhet në bazë të personave të punësuar, të cilët kanë një tarifë fikse për çdo nivel pune në kompani të paracaktuara në një kontratë ligjore të lidhur më parë midis të dy palëve në bashkëpunim

Studimet sugjerojnë se tregu i rekrutimit të punonjësve nëpërmjet firmave të rekrutimit është dinamik dhe në rritje të shpejtë, dhe organizatat që kanë transferuar disa funksione të burimeve njerëzore, kanë shpejtësi në procesin e rekrutimit dhe mbledhja e të dhënave shtesë krijon mundësinë për informacion më të mirë dhe planifikim më efikas (Louis Fall & P. Zhang. Y, 2012; fq.6).

Kompanitë e përfshira në punim shprehen se presin rritje të përdorimit të firmave të rekrutimit, pasi planbizneset e tyre parashikojnë rritje të aktivitetit të tyre në vitet e ardhshme dhe në këtë mënyrë edhe rritje të punonjësve.

Rekrutimi me anë të nënkontraktimit është i lidhur në mënyrë të konsiderueshme me zgjedhjen e talentëve për punësim. Organizatat që kanë aplikime të mëdha të kandidatëve për punësim e konsiderojnë pozitive përdorimin e firmave të rekrutimit për punësimin dhe përfundimisht ndikojnë në qëllimet e punësimit.

Hulumtimet shqyrtojnë se variablat e shumta të procesit të rekrutimit, të tilla si madhësia dhe cilësia e aplikantëve për punë, përbërja e aplikantit, koha për ta plotësuar postin kërkojnë një shpenzim energjish të konsiderueshëm brenda organizatës, e cila mund të shmanget me angazhimin e firmave të rekrutimit në procesin e rekrutimit, mënyrë e cila është mjaft efektive për kompanitë ku ofertat dhe kërkesat për punë janë të mëdha (Jian Han & Christopher J. Collins, 2002).

Pozitiviteti i firmave të rekrutimit në procesin e rekrutimit të punonjësve raportohet edhe nga kompanitë e përfshira në studimin tonë. Kompanitë mendojnë se bashkëpunimi ka ndikuar pozitivisht në zgjedhjen e kandidatit më të mirë dhe rrjedhimisht ajo është pasqyruar edhe në performancën e kompanisë (Louis Fall. & P. Zhang.Y, 2012; Kosnik.T, Wong-MingJi & D, Green.G; 2004).

Kontraktimi i burimeve të jashtme (Outsourcing) është bërë një praktikë mjaft e njohur dhe e përdorshme në botën e biznesit, është një realitet dhe forma të reja të tij vazhdojnë të përparojnë (Despoti. M, 2007).

Në anketimin e bërë kompanitë e marra në shqyrtim shprehin një vlerësim të mirë dhe janë të kënaqur që bashkëpunojnë dhe përdorin firmat e rekrutimit të punonjësve për vendet e lira të punës në kompanitë e tyre, madje kanë krijuar besim të tillë sa nuk ngurojnë të japin referenca edhe për kompani të tjera

Prirja për outsourcing po vjen në rritje edhe në Shqipëri, sidomos në sektorin e shërbimeve, tre nga pesë kompanitë e marra në studimin tonë mendojnë se nënkontraktimi i rekrutimit do të ketë të ardhme, dy prej kompanive janë të paqarta për këtë gjë dhe kjo lidhet me çfarë drejtimi do të marrë ekonomia e vendit.

6. Konkluzione dhe rekomandime

Konkurrenca në tregje, kërkesa për punonjës gjithnjë e më të talentuar detyron bizneset që të transferojnë shërbimet tek një kontraktor, por kjo është e këshillueshme të bëhet vetëm për funksione të diferencuara të burimeve njerëzore.

Funksioni i burimeve njerëzore është konsideruar në thelb i rëndësishëm dhe strategjik për të gjitha organizatat dhe për këtë arsye gabimet e kontraktorit, në se ndodhin do të jenë shumë të kushtueshme për bizneset.

Kontraktimi i rekrutimit në BNJ është një mënyrë për të përmirësuar efikasitetin e procesit të rekrutimit dhe kjo është arsyeja që ky proces po vjen në rritje brenda kompanive të konsulencës që e zhvillojnë, por dhe në numër të kompanive të konsulencës që merren me këtë biznes.

Organizatat e biznesit, kryesisht ato të mëdha dhe mesme, nëkontraktajnë shërbimin e rekrutimit për të ulur kostot, për të gjetur talente dhe për më shumë efikasitet në procesin e rekrutimit.

Përzgjedhja e një firme rekrutimi, bëhet kryesisht mbi bazën e reputacionit dhe specializimit të saj dhe nga kërkimi ynë rezultoi që Dynamics Partners ishte firma me më shumë klientë dhe e specializuar për funksionet e BNJ-së.

Forma e bashkëpunimit me firmat e rekrutimit në përgjithësi është sipas nevojave specifike të kompanisë gjatë procesit të rekrutimit, sepse një pjesë të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore kryhen nga departament e burimeve njerëzore që të gjitha kompanitë e marra në shqyrtim e kanë funksional brenda tyre.

Firmat e rekrutimit kryejnë kryesisht rekrutime të nivelit të mesëm menaxherial, nivelit mbikqyrës dhe të pozicioneve specifike, niveli i drejtuesve ekzekutivë përcaktohet nga kompanitë mëmë ose nga pronësia, ndërkohë që koha mesatare për të përfunduar procesin e rekrutimit me outsourcing varion nga 15 ditë deri në 2 muaj.

Indikator i matës që merret në konsideratë për të vlerësuar efikasitetin e firmës së rekrutimit është *koha e përfundimit të procesit të rekrutimit*. Marrëveshja kontraktuale ishte i tillë midis kompanisë dhe firmës së rekrutimit, që kompania informohej nga firma e rekrutimit rreth kandidatit dhe aprovimi merrej absolutisht prej saj, performanca e kandidatit nuk merrej si indikator matës, sepse përgjegjësia hiqej nga firma e rekrutimit.

Forma e bashkëpunimit me firmat e rekrutimit (sipas nevojës), rrjedhimisht në të shumtën e rasteve vendoste edhe mënyrën e pagesës, e cila bëhej në bazë të personave të punësuar, por gjetëm dhe formën e pagesës më tarifë mujore.

Duke u bazuar në planbizneset e tyre, të cilat parashikojnë rritje në të ardhmen, kompanitë e përfshira në studim mendojnë se procesi i kontraktimit të rekrutimit në të ardhmen do të ketë rritje, bazuar kjo edhe në përvojat e tyre rreth ndikimit pozitiv të firmave të rekrutimit në kompanitë e tyre dhe përshtypjet e mira që kanë për to. Rrjedhimisht, ato besojnë se procesi i rekrutimit nëpërmjet firmave të rekrutimit do të ketë të ardhme në Shqipëri.

Bibliografia

- Belcourt, M. (2006) *Outsourcing: the benefits and the risks*, Human Resource Management Review, 16(2), fq.269-279 Birtch, T.A., Chiang, F.F.T. and Chow I.H-S. (2010) *Examining human resource management outsourcing in Hong Kong*, The International Journal of Human, Resource Management, 21(15) fq. 2762-2777
- Butler G.M, Carolyn M. & Callahan B (2012). *Human resource outsourcing: Market and operating performance effects of administrative HR functions*. Journal of Business Research, pp.2-23; <http://vahabonline.com/wpcontent/uploads/2013/08/66450005005545.pdf>
- Cooke, F.L; McBride, A. and Shen, J. (2005) *Outsourcing HR as a competitive strategy? A literature review and an assessment of implications*, Human Resource Management, 44(4) fq. 413-432
- Darling, Peter (Aug 2007). *Disabilities and the Workplace*. Business NH Magazine 24 (8): 28. <http://connection.ebscohost.com/c/articles/26187580/disabilities-workplace>
- Despoti. M, (2007). *Outsourcing, përdorim i gjerë dhe në Shqipëri: Përdorimi i burimeve të jashtme-Fushe beteja e ardhshme e biznesit*. <http://www.monitor.al/perdorimi-i-burimeve-te-jashtme-fushe-beteja-e-ardhshme-e-biznesit-941/>
- Greer, C.R., Gray, D.A. and Youngblood, S..A. (1999) *Human resource management outsourcing: The make or buy decision*, Academy of Management Executive, 13(3), fq.85-96
- Gurney, M., Newham, T., Scott-Jackson, W. and Woodall, J. (2009) *Making the decision to outsource Human Resources*, Personnel Review, 38(3), fq.236-252.
- Gilley, K.M., Greer, C.R., and Rasheed, A.A. (2004) *Human Resource Outsourcing and organizational performance in manufacturing firms*, Journal of Business Research, 57(3) fq.232-240
- Hanson, G. (2003), *“What Has Happened to Wages in Mexico Since NAFTA”*, NBER Working Paper Series, National Bureau of Economic Research, Cambridge, MA.
- HR consultant. CNN Money. Retrieved 23 December 2011. <http://money.time.com/magazines/moneymag/bestjobs/2010/snapshots/43.html>
- Jamil. R and Naeem.H (2013). *The Impact of Outsourcing External Recruitment Process on the Employee Commitment and Loyalty: Empirical Evidence from the Telecommunication Sector of Pakistan*. IOSR Journal of Business and Management (IOSR-JBM) e-ISSN: 2278-487X. Volume 8, Issue 2 (Jan. - Feb. 2013), PP 69-75. <http://iosrjournals.org/iosr-jbm/papers/Vol8-issue2/I0826975.pdf>
- Johnason, P. (2009). *HRM in changing organizational contexts*. In D. G. Collings & G. Wood (Eds.), Human resource management: A critical approach (pp. 19-37). London: Routledge.
- Klerck, G. (2009). *Industrial relations and human resource management*. In D. G. Collings & G. Wood (Eds.), Human resource management: A critical approach (pp. 238-259). London: Routledge.
- Kosnik.T, Wong-MingJi.D, Green.G (2004). *Outsourcing vs insourcing in the human resource supply chain: a comparison of five generic models*, pp.671-689 <http://www.visusgroup.com/articles/outsourcing.pdf>
- Liebermann .R. K. (2009). *Calibrating Human Resources to Company Size. HR Insourcing*, Issue: #1 A Publication of HR Insourcing, LLC <http://ëëë.hrinsourcing.com/pdfs/HRI-108NEËSLETTER-No1d.pdf>
- Klaas, B.S., McLendon, J.A. and Gainey, T.W. (2001) *Outsourcing HR: the impact of organizational characteristics*, Human Resource Management, 40(2), fq.125-38
- Lepak, D.P. and Snell, S.A. (1998) *Virtual HR: Strategic human resource management in the 21st century*, Human Resource Management Review, 8(3), fq.215-234.
- Louis Fall. P, Zhang. Y (2012). *Staff recruitment in United Nations system organizations: a comparative analysis and benchmarking framework: The recruitment process*. Joint Inspection Unit Geneva, United Nations, fq.6-44. https://ëëë.unjiu.org/en/reports-notes/jiu_products/jiu_note_2012_2_english.pdf
- Merkle, Judith A. (1980). *Management and Ideology: The Legacy of the International Scientific Management*

- California Press. ISBN 0-520-03737-5. <http://www.ucpress.edu/op.php?isbn=9780520037373>
- Raju, M (2013). *Evaluating the Recruitment Process*. <http://www.adroitpeople.com.au/evaluating-recruitment-process/>
- Taplin, R (2008). *Outsourcing, innovation and risk*. Director of the Centre for Japanese and East Asian Studies. <http://ip-science.thomsonreuters.com/m/pdfs/klnl/2008-03/outsourcing.pdf>
- Seth, M & Sethi, D (2011). *Human Resource Outsourcing: Analysis Based On Literature Review*. International Journal of Innovation, Management and Technology, Vol. 2, No. 2, pp.2 <http://ijimt.org/papers/118-M514.pdf>
- Scott D. Stewart (2013). *Manager Selection*. Research Foundation of CFA Institute Vol. No.4. <http://www.cfainstitute.org/learning/products/publications/rf/Pages/rf.v2013.n4.1.aspx?WPID=AlsoViewedProducts>
- Sundheim, K (2013). *A Guide To Hiring Recruitment Firm*. Përditësuar më: 19/09/2013. E disponueshme në: <http://www.forbes.com/sites/kensundheim/2013/09/19/331/>

PËRSHTATJA NË SHQIP E PYETËSORIT TË MOTIVIMIT TË SHKENCAVE NË FORMËN E PYETËSORIT TË MOTIVIMIT NË LËNDËN E FIZIKËS

AHMED FATIH ERSOY

Universiteti Epoka, Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Departamenti Inxhinieri Kompjuterike, afersoy@epoka.edu.al

YLLJET ALIÇKA

Universiteti European i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, Edukimi, ylljet.alicka@uet.edu.al

ABSTRAKT

Ky studim ka për qëllim të krijojë një mjedis laboratorik, në të cilin nxënësit mund të sillen si shkencëtarët. Ky studim synon të përshatë në gjuhën shqipe PyetëSORIN e Motivimit të Shkencave (Science Motivation Questionnaire) të shtjelluar nga Glynn dhe Koballa (2006), në formën e PyetëSORIT të Motivimit në Lëndën e Fizikës, dhe raportet e vlefshmërisë dhe besueshmërisë së studimit. Kampioni i të anketuarve janë 110 persona të përzgjedhur nga nxënës të shkollave të mesme në Shqipëri. Të dhënat e mbledhura janë analizuar dhe strukturat e faktorëve të ngjashëm kanë rezultuar sikundër në pyetëSOR. Bazuar në Analizat e Komponentëve Parësorë (Principal Component Analysis) kanë dhënë rezultate të ndara në gjashtë grupe: vetvetiu motivojnë mësimin e lëndës së fizikës, faktorët e jashtëm motivojnë mësimin e lëndës së fizikës, vetëbesimi në të mësuarit e lëndës së fizikës, përshtatshmëria e të mësuarit të lëndës së fizikës për qëllime personale, ankthi në kontrollin e njohurive të lëndës së fizikës, dhe vetë vendosmëria për të mësuar lëndën e fizikës. Besueshmëria Alfa e Cronbach ka rezultuar në masën 0.805. Ky pyetëSOR ka për qëllim të përcaktojë motivimin e nxënësve të shkollave të mesme në mësimin e lëndës së fizikës. Në kushtet kur efekti pozitiv i motivimit për të mësuar lëndën e fizikës dhe arritja rezultojnë të jetë një proces i paramenduar, është e rëndësishme që të përcaktohet motivimi i nxënësve; konstruktet motivuese mund të hulumtohen dhe aktivitete që përmirësojnë motivimin për të mësuar lëndën e fizikës mund të zhvillohen. Përveç kësaj, dallimet e mundshme gjinore në motivimin për të mësuar lëndën e fizikës janë analizuar për të identifikuar nëse ka mospërputhje ndërmjet femrave dhe meshkujve të llogaritur në motivimin për të mësuar lëndën e fizikës.

Fjalë kyç: fizika, lëndët shkencore në Shkollat e Mesme, ligjet e Njutonit, motivimi, edukimi, gjinia

Hyrje

Max Tegmark (2015) thotë se “fizika është aventura më e fundit intelektuale, një kërkim i hollësishëm për të kuptuar misteret më të thella të universit tonë”. “Fizika nuk ka të bëjë me diçka interesante dhe ta shndërrojë atë në të mërzitshme. Përkundrazi, ajo na ndihmon të shohim më qartë, duke i shtuar vetes bukurinë dhe mrekullinë e botës që na rrethon”. Në fakt, pikërisht ndikimi tek nxënësit dhe pikërisht krijimi i kësaj ndjesie, duhet të jetë qëllimi kryesor i lëndëve dhe kurseve të shkencave ekzakte, çka do të rriste motivimin e tyre në të kuptuarit e rëndësisë për të mësuar lëndët e shkencave ekzakte dhe do të kishte efekte pozitive në rezultatet e tyre. (Singh, Granville, dhe Dika, 2002).

Sipas Pintrich dhe Shuk (2002), motivimi mund të përkufizohet si “procesi përmes së cilës veprimtaria qëllim-drejtim është e nxitur dhe e qëndrueshme”. Motivimi ka efekte në fillimin ose kohëzgjatjen e sjelljeve. Studimet mbi motivimin, tregojnë se rezultatet e të mësuarit tek nxënësit janë të lidhura pozitivisht me motivimin e tyre për të mësuar. (Zusho, Pintrich, – Coppalo, 2003; Jacobsen, Eggen, & Kauchak, 2002; Pintrich, Marx, & Boyle, 1993). Për këtë arsye, hartuesit e kurrikulave dhe mësuesit, duhet të marrin parasysh rëndësinë e motivimit për të mësuar lëndët e shkencave ekzakte.

Studimet dhe literatura gjithashtu tregojnë qartë se nxënësit në thelb janë më të motivuar në rastet kur mësuesit nxisin interesin dhe lidhjen e nxënësve në një lëndë të ideuar dhe projektuar mbi baza motivuese. (Singh, Granville, & Dika, 2002; Entwistle 1986). Përveç kësaj, këto studime sugjerojnë mjedise aktive të të mësuarit për nxënësit, dhe në mënyrë që të rritet motivimi i nxënësve, duhet të zhvillohen dhe mjetet motivuese.

Në ditët e sotme është e pamundur që të mos marrim në konsideratë ndikimin e shkencës në botë dhe në jetët tona. Një nga objektivat kryesore të programeve të shkollave të mesme dhe universiteteve është pikërisht përgatitja e individëve shkencërisht të shkolluar.

Personat me kompetenca shkencore, nuk duhet të vlerësojnë vetëm informacionet shkencore të gatshme por dhe metodat e përdorimit për ta prodhuar atë. Personat me kompetenca shkencore, duhet të përshtatin konceptet shkencore, duhet të vlerësojnë dhe të bëjnë diskutime shkencore dhe të përdorin terminologjinë teknike (De Boer, 2000; Reveles, Cordova and Kelly, 2004; Glynn, Taasobshirazi and Brickman, 2007).

Personat me kompetencat shkencore në edukimin e tyre duhet të ketë një vend të rëndësishëm në rritjen e motivimit në sigurinë e studenteve dhe kjo nuk ka të bëjë me shkencën. Motivimi, Glynn dhe Koballa (2006), njihet si një gjendje e brendshme që menaxhohet dhe drejtohet nga sjellja e studenteve. Motivimi në teorinë e mësimit social-njohëse: karakteristikat e sjelljeve të studentëve merren së bashku me mjediset e mësimit (Alderman, 2004; Glynn, Taasobshirazi and Brickman, 2009). Nga ana tjetër motivimi ka tre vjet që është trajtuar me më shumë funksion psikologjik (İlhan, Yıldırım, & Yılmaz, 2012). Këto janë i) sjellja aktive që kalon në gjendje, gjë që i mban studentët të lidhur ose i drejton drejt mësimit, për shembull: studentet çdo javë duan të zgjidhin probleme të ndryshme të matematikës: ii) Drejtimi i sjelljes, në punët që bëjnë studentët si fillim duhen drejtuar radhët e tyre, për shembull: studentët para se të argëtohen duhet që të punojnë, dhe iii) për të pasur nën kontroll në vazhdimësi sjelljen duhet këmbëngulur në qëllimet e studenteve, për shembull: edhe pse studenti nuk ka marrë një burse, viziton gjithë shtetin.

Për të vlerësuar motivimin e nxënësve në mësimin e lëndës së fizikës mund të përdoret një pyetësor. Ndërkohë që për përcaktimin e motivimit të nxënësve për të mësuar fizikë nga Glynn dhe Koballa (2006) është ideuar dhe zbuluar Pyetësori i Motivimit në Lëndët Shkencore. Megjithatë, në vendin tonë nuk ekzistojnë mjaftueshëm studime mbi motivimin për të mësuar lëndën e fizikës. Arsyeja dhe shkak i kësaj mund të jetë fakti se ende nuk ekziston një pyetësor i besueshëm dhe i vlefshëm, i cili mat motivimin e nxënësve për të mësuar lëndën e fizikës. Ky studim synon të përshtatë në gjuhën shqipe Pyetësorin e Motivimit të Shkencave [Science Motivation Questionnaire (SMQ)], në formën e Pyetësorit të Motivimit në Lëndën e Fizikës.

Për më tepër, ekzistojnë disa studime, të cilat tregojnë se dallimet gjinore në motivimin në lëndët shkencore janë prezente (Britner & Pajares, 2001; Debacker & Nelson, 2000; Meece & Jones, 1996; Pintrich & SCHUNK, 2002). Përkatesia gjinore është konsideruar si një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në qëndrimet ndaj lëndëve shkencore (Zeyer, Bülsterli, Brovelli, dhe Oderm, 2012). Për këtë arsye, ky studim gjithashtu ka për qëllim të shqyrtojë nëse ka dallime gjinore në motivimin për të mësuar lëndën e fizikës.

1. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Ndërtimi i një mjedisi motivues në klasë, është një faktor i rëndësishëm për të mësuar në mënyrë kuptimplotë lëndën e fizikës edhe pse një gjë e tillë është vështirësish e realizueshme. Kur efekti pozitiv i motivimit për të mësuar lëndën e fizikës dhe arritjet janë të menduara në detaje, është tejet e rëndësishme që të përcaktohet motivimi i nxënësve; prandaj, mund të hulumtohet konstrukti i motivimit dhe mund të zhvillohen aktivitete që përmirësojnë motivimin e nxënësve për të mësuar lëndën e fizikës.

Vlerësimi i motivimit të nxënësve për të mësuar lëndën e fizikës merr një rol të rëndësishëm, ndaj qëllimi kryesor i studimit është përshtatja e Pyetësorit të Motivimit në Lëndët Shkencore në kontekstin kulturor shqiptar si Pyetësori i Motivimit të Lëndës së Fizikës dhe për të identifikuar strukturën faktoriale.

Në teorinë social-njohëse e të mësuarit: karakteristikat e nxënësve janë konsideruar të jene interaktive me sjelljen dhe mjedisin e të mësuarit. Për të kontribuar në të ardhmen e personit në nivel personal: kjo bën të mundur për të zhvilluar aftësitë

e tyre në qëllimet e tyre, (Bandura, 1989). Këto rregulla e të mësuarit teorik janë më shumë vetë-rregulluese (self regulated) që ndikojnë në kohën e të mësuarit. Vetë-rregullim: qëllimet e mendimeve, ndjenjave dhe veprimeve të personave janë të njohura si përpjekjet sistematike që tregojnë drejtimin për të arritur tek këto qëllime. (Schunk, 2001; Ergül, 2006; Glynn et al., 2009). Në sistemin e të mësuarit vetë-rregullues është raportuar të jenë së paku 6 struktura bazë në motivimin e të mësuarit të nxënësve. Këto janë përcaktuar: i) Motivimi i brendshëm, ii) Motivimi i jashtëm, iii) Orientim target, iv) Vetëvendosja, v) Vetë efikasiteti, vi) Ankth vlerësimi. (Bandura, 2001; Schunk, 2001; Glynn et al., 2007).

SMQ përbëhet nga 6 kolona (Glynnand Koballa, 2006; Glynn et al., 2007; Glynn et al., 2009). Këto janë:

- ← Motivimi i brendshëm: është që të sigurojë motivimin e brendshëm ndaj të mësuarit.
- ← Motivimi i jashtëm: është si një mjet i të mësuarit që ka një objektivi që duhet të arrihet me fundin e rritjes së motivimit që është motivimi i jashtëm. Studentet shpesh janë të motivuar si brenda dhe jashtë. Për shembull nxënësit mund të gëzohen për projekte shkencore të kryera në të njëjtën kohë ku mund të vlerësohen me çmime në fund të projekteve të realizuara. Me këtë rast nxënësit janë të motivuar dhe nga ana e brendshme dhe nga ana e jashtme. (Glynnand Koballa, 2006; Glynn et al., 2007; Glynn et al., 2009).
- ← Përshtatshmëria personale, (personal relevance): me synimin për të mësuar përshtatshmërinë personale (learning goals) ose me qëllimin e performancës, (performance goals). Kur nxënësit nuk janë shumë të aftë në shkencë por fokusohen në të mësuarit, këta studente për të kapërcyer vështirësitë dhe gabimet e shumta që ata kryejnë nuk janë të interesuar në mënyrën se si ata vëzhgohen nga njerëzit. Gabimet e tyre janë vrojtuar si mundësi për të mësuar dhe janë të favorshme për njerëzit e tjerë që ndihmohen. Ndërsa nxënësit që kanë synim performancën për të fituar një status social shmangin ndonjë punë ekstra duke i gëzuar mësuesit me punën e tyre. Marrin lëndët me notat më të larta. (Glynn and Koballa, 2006; Glynn et al., 2007; Glynn et al., 2009).
- ← Vetëvendosja (self determination). Në mësimet e studenteve nënkuptohet që ata të kenë zgjedhje dhe kontroll. Nëse ata kanë mundësi për të zgjedhur detyrat e tyre ata do të kenë më shumë mundësi për të përfutur nga punët e tyre. Në hulumtimet e vazhdueshme të bëra, roli përfshirës i studenteve në vendimet në lidhje me vazhdimësinë e lëndës (si vendimet për mësimin e lëndëve, përzgjedhjen e shkrimtareve dhe temat e lexuesve) ka rritur motivimin e brendshëm tek ata. Dhe rritja e perceptimit të vështirësive të motivimit të studenteve në vetëvendosje është e vështirë. (Glynn and Koballa, 2006; Glynn et al., 2009).
- ← Vetë efikasiteti (self efficacy): individët mendojnë për të mos qenë të suksesshëm në detyrat që ata marrim përsipër, (Alderman, 2004; Glynn et al., 2009). Vetë efikasiteti ndikon në përzgjedhjen e aktiviteteve ku përfshihet dhe karriera.
- ← Ankth vlerësimi (assessment anxiety): ankthi në shkallë të mesme ndikon në motivimin e të mësuarit të nxënësve. Shkalla e lartë e ankthit ndikon negativisht në arritjen dhe motivimin e nxënësve (Glynn and Koballa, 2006; Glynn et al., 2007; Glynn et al., 2009).

Në këtë punim janë përshtatur 6 komponentë themelore të cilët përfshijnë 30 substanca PMQ-je. 5-PMQ-të janë vënë sipas rezultatit të shkallës Likert. Substancat e përfshira në anketë nga Asnjëherë (1) drejt Gjithmonë (5) janë krijuar për të mbledhur të dhënat bazë sipas rezultatit të saktë. Në anketën “shqetësim vlerësim” substancat e gjetura në komponentët themelore përfshihen brenda substancave negative. Llogaritjet janë të bazuara në rezultatet e këtyre substancave që janë konsideruar nga 5 gradë deri në 1 gradë.

PMQ ka për qëllim të vlerësojë motivimin e nxënësve të shkollave të mesme për të mësuar lëndën e fizikës. Përveç kësaj, dallimet gjinore në motivimin për të mësuar lëndën e fizikës janë analizuar në mënyrë të tillë që të mundësojnë identifikimin, nëse ka mospërputhje në të dhënat e motivimit ndërmjet femrave dhe meshkujve.

2. Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Pyetjet hulumtuese të këtij studimi ishin si më poshtë vijon:

- ← A është Pyetësori i Motivimit në Lëndën e Fizikës (PMQ) i besueshëm për t'u përdorur në kontekstin shqiptar për të vlerësuar motivimin e nxënësve në shkollat e mesme në mësimin e lëndës së fizikës?
- ← A ndryshojnë femrat dhe meshkujt në aspekte që lidhen me motivimin e përgjithshëm për të mësuar lëndën e fizikës?
- ← A janë femrat më të motivuara se meshkujt në aspektin; vetvetiu motivojnë mësimin e lëndës së fizikës, faktorët e jashtëm motivojnë mësimin e lëndës së fizikës, vetëbesimi në të mësuarit e lëndës së fizikës, përshtatshmëria e të mësuarit të lëndës së fizikës për qëllime personale, ankthi në kontrollin e njohurive të lëndës së fizikës, dhe vetëvendosmëria për të mësuar lëndën e fizikës?

Seksioni i metodologjisë përbëhet nga tri pjesë, të cilat janë instrumentet/përçimi, mostrat, dhe analiza e të dhënave.

a. Instrumentet

PMQ (shih pyetësorin origjinal dhe të adoptuar në shtojcë) përbëhet nga 30 artikuj në një 5-pikë e modelit Likert. Kategoritë

e përgjigjeve ishin “kurrë”, “rrallë”, “ndonjëherë”, “zakonisht”, dhe “gjithmonë”. Komponentët e pyetësorit janë vetvetiu motivojnë mësimin e lëndës së fizikës, (i etiketuar si i brendshëm), faktorët e jashtë motivojnë mësimin e lëndës së fizikës (motivimi i jashtëm), rëndësia e të mësuarit fizikës për qëllimet personale (rëndësia), përgjegjësia (vetëvendosje) për mësimin e lëndës së fizikës (përgjegjësi), besimi (vetë efikasiteti) në mësimin e lëndës së fizikës (besimi), dhe ankthi në kontrollin e njohurive të lëndës së fizikës (ankthi). Koeficienti i besueshmërisë alfa të Cronbach është 0.93, që do të thotë se të paktën 93% të variancës së përgjithshme rezultatin është për shkak të mospërputhjes së vërtetë me rezultatin.

b. Përkthimi

Në kushtet e vlefshmërisë, procesi i përkthimit është kryer sërish nga hulumtuesit. Ndërkohë tre hulumtues të pavarur dygjuhësh kanë përkthyer pyetësorin origjinal në gjuhën shqipe, duke lejuar interpretimin divergjent të artikujve me kuptim të paqartë në pyetësorin origjinal. Çdo përkthim është bërë individualisht dhe pastaj janë krahasuar mospërputhjet. Më pas, pyetësori i përkthyer është ripërkthyer sërish në gjuhën angleze nga dy studiues të tjerë, të cilët nuk kanë njohuri të pyetësorit në mënyrë që të kontrollohej konsistenca me pyetësorin e përkthyer me atë origjinal. Kjo metodë e përdorur kishte për qëllim të konstatonte nëse kishte ndonjë paqartësi në çështjet, dhe gjithashtu synonte të konstatonte ekuivalenca konceptuale dhe kulturore. Më pas, versioni shqip i pyetësorit është rishikuar. Përveç kësaj, për fazën finale të përshtatjes dhe në mënyrë që të kontrollonte vlefshmërinë e paraqitjes dhe përmbajtjes, pyetësori i përkthyer është administruar për 14 nxënës të shkollave të mesme.

Bazuar në reagimet (feedback-u), pyetësori është rishikuar dhe me konsensus janë bërë ndryshime të vogla; dhe më pas është formuluar versioni përfundimtar i PMQ, i përkthyer. Në përfundim, versioni final i pyetësorit është administruar për 110 nxënës të shkollave të mesme.

c. Kampioni i të anketuarve

Kampioni i këtij studimi përbëhej nga 110 nxënës të shkollave të mesme nga katër shkolla të ndryshme të mesme në të gjithë Shqipërinë. Studimi është kryer me 55 nxënës femra dhe 54 nxënës meshkuj, ndërsa një student nuk ka deklaruar gjininë. Pyetësori është administruar gjatë zhvillimit të lëndëve të fizike dhe ka zgjatur rreth pesëmbëdhjetë minuta.

d. Analizimi i të dhënave

Të dhënat e mbledhura nga nxënësit e shkollave të mesme janë analizuar nëpërmjet programit SPSS 21,0 për Windows. Përgjigja nxënësve përputhej me reagimin e tyre (për shembull, kurrë=1 ose gjithmonë=5). Ankthi në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me lëndën e fizikës ishin pika të koduara në mënyrë reverse/të kundërt; prandaj pikat që kishin të bënin me ankthin në lidhje me komponentin e vlerësimit të lëndës së fizikës u rikodua sërish (për shembull, në qoftë se përgjigja e nxënësit është 1, ajo ishte e shënuar me si një 5.). Rezultati maksimal është 150 dhe rezultati minimal është 30.

Besueshmëria e PMQ është analizuar nga konsistenca e brendshme, e cila është vlerësuar nëpërmjet alfa e Cronbach. Për studimet arsimore, vlera e sugjeruar alfa është të paktën 0,70 dhe mundësisht më e lartë (Fraenkel & Wallén, 2003, f. 168).

3. Analizë, interpretim të dhënash

Artikujt e PMQ u janë nënshtruar analizës së komponentëve të principalit (PCA) vlera Kaiser-Meyer-Olkin rezulton. 783, duke shprehur përshtatshmërinë e të dhënave për analizën e faktorëve, tejkalonte vlerën e rekomanduar 0.6 (Field, 2000). Përveç kësaj, testi i Bartlett i sferoidit arrin rëndësinë statistikore në mbështetje të faktorabilitetit të matricës të korrelacionit

($\chi^2 = 435$, PCA gjashtë konentë nin v[eigen-values]1, cilat ishin

r Dve, nentët u etiketuan retvetiu motivojnë mësimin e lëndës oliv vetëbesimi në të mësuar fizikës (6 ar rit të lëndës së fizikës për qëllime personale (5 arët e jashtëm motiv mësimin e lëndës së fizikës (6 ar (për të dhënat e secilit ko Tabelën 1). Koeficienti i besueshmëryetësorlitur nga alfa Croch ishte 0.805, duke trendshme të laria e koeficientit Spearo është secilit kookatësisht 0.635,(T

TABELA NR. 1: TË DHËNAT E FAKTORËVE PËR SECILIN KOMPONENT.

	Component					
	Factor 1	Factor 2	Factor 3	Factor 4	Factor 5	Factor 6
Mot01	,808					
Mot30	,790		-,300			-,370
Mot16	,789				,378	
Mot02	,722			,370		
Mot22	,649	-,315		,346		
Mot03		,607	-,473	,375		
Mot12		,510				
Mot07		,761				
Mot17		,711				
Mot14		,646		-,473		
Mot15	-,331	,635				
Mot29			,755			
Mot24			,749		,320	
Mot21			,719			
Mot26			,660			-,323
Mot28		-,419	,622	,433	,337	
Mot19			,578	,461	,340	,337
Mot06	,522			,790		
Mot18	,411		-,304	,764		
Mot13				,746	,317	
Mot04	,307	,345		,380		
Mot23		,377			,719	
Mot10		-,502	-,413	,304	,652	
Mot11	,355			,499	,504	-,309
Mot27					,422	-,352
Mot25					,763	
Mot20			-,310			,737
Mot05	-,411			,409		,687
Mot08			-,366	,425		-,605
Mot09	,405			,374		-,478

Extraction Method: Principal Component Analysis.

Rotation Method: Oblimin with Kaiser Normalization.

Shënim. Vetëm të dhënat .3 janë shfaqur.

Të gjashtë faktorët shpjegojnë gjithsej 59.653% të variancës, me kontribut të komponentit të motivimi i brendshëm 26.517%, kontributi i komponentit të motivimi i jashtëm 10.013%, kontributi i komponentit të besueshmëria 8.073%, kontributi i komponentit të relevancës 5.975%, kontributi i komponentit ankthit 4.962%, dhe kontributi i komponentit të përgjegjësisë 4.112% (Tabela 2).

TABELA NR. 2: FACTOR ANALYSIS SCORES FOR EACH COMPONENT.

Components	Eigen Values	Variance explained	Reliability (Cronbach's alpha)
Intrinsic (brendshem)	7.955	26.517%	0.635
Extrinsic (jashtem)	3.004	10.013%	0.539
Confidence (besueshmeria)	2.422	8.073%	0.704
Relevance (relevancës)	1.792	5.975%	0.683
Anxiety (ankthit)	1.489	4.962%	0.794
Responsibility (përgjegjësisë)	1.234	4.112%	0.433
Total variance explained		59.653%	
Cronbach's alpha			0.805

Interpretimi i pyetësorit rezultoi në përputhje të plotë me hulumtimet e mëparshme në SMQ me të gjashtë komponentët, që janë teorikisht dhe statistikisht të justifikuar (Glynn & Koballa, 2006, Glynn, Taasoobshirazi, dhe Brickman, 2007).

Këto komponentë janë të mësuarit të motivuarit në thelb të lëndës së fizikës, ankthi në lidhje me vlerësimin e lëndës së fizikës, besimi në të mësuarit të lëndës së fizikës, rëndësia e mësimit të lëndës së fizikës për qëllimeve personale, të mësuarit e lëndës së fizikës të motivuar nga faktorë të jashtëm, dhe përgjegjësia për mësimin e lëndës së fizikës.

Besueshmëria alfës Cronbach, të secilit komponent ishte respektivisht 0.635, 0.539, 0.704, 0.683, 0.794, dhe 0.433. Alfa e Cronbach ($\alpha = 0.805$) dhe besueshmëria Spearman-Brown ($r = 0.653$) ishte e pranueshme për të gjithë pyetësorin e motivimit të lëndës së fizikës (vlera e rekomanduar alfës Cronbach duhet të jetë më e madh se 0,70). Versioni shqiptar i konsistencës së brendshme të PMQ ($\alpha = 805$) është pak më e vogël se ajo e versionit anglisht të konsistencën së brendshme të pyetësorit ($\alpha=0.93$).

Bazuar në këto gjetje, mund të interpretohet se adaptimi i këtij pyetësori është i suksesshëm sepse tregon besueshmëri të kënaqshme dhe rezultate të vlefshme si dhe është e përshtatshme që PMQ të përdoret në kontekstin shqiptar për të vlerësuar motivimin e nxënësve për të mësuar lëndën e fizikës. Përveç kësaj, versionet e ngjashme të këtij pyetësori mund të përshtaten për disiplinat e tjera si kimi, fizikë, apo biologji.

Përveç studimeve të besueshmërisë dhe vlefshmërisë, dallimet e mundshme gjinore në motivimin për të mësuar lëndën e fizikës synonin të ishin studimorë. Duke marrë në konsideratë rezultatet totale, motivimi për studentët femra dhe ata meshkuj të shkollave të mesme, nuk rezultuan dallime të rëndësishme statistikore.

Rezultati mesatar i nxënësve femra në shkollat e larta rezultoi 107 dhe rezultati mesatar i nxënësve meshkuj rezultoi 109, i cili shprehu motivim të moderuar (nganjëherë deri më shpesh) për të mësuar fizikën. Megjithatë, me analizimin e çdo komponenti, statistikisht janë gjetur dallime të mëdha në aspektin e gjinisë.

Rezultatet për ankthin e vlerësimin të lëndës së fizikës dhe faktorët e jashtëm të mësimit të lëndës së fizikës, janë gjetur statistikisht të ndryshme në aspektin e gjinisë; që do të thotë se rezultatet që konsiderojnë komponentët e ankthit dhe atyre jothelbësore tek nxënësit e shkollave të mesme femra dhe meshkuj, janë të ndryshme nga njëri-tjetri. Me fjalë të tjera, këto dallime gjinore nënkuptojnë që nxënëset femra dhe meshkuj të shkollave të mesme, nuk janë të ngjashme në aspekte që lidhen me komponentët e ankthit rreth vlerësimin të fizikës dhe të mësuarit të lëndës së fizikës të motivuar nga faktorë të jashtëm.

Nga ana tjetër, dallimet gjinore që janë analizuar në aspekte që lidhen me përgjegjësinë për të mësuar lëndën e fizikës, nuk kanë rezultuar dallime të mëdha; që do të thotë se përgjegjësia e nxënësve të shkollave të mesme femra dhe meshkuj për të mësuar lëndën e fizikës nuk ndryshon. Rezultatet të ngjashme janë gjetur për komponentët e tjerë që ishin të motivuar thelbësisht me mësimin e lëndës së fizikës, besimin në të mësuarit e lëndës së fizikës dhe rëndësinë për të mësuar lëndën e fizikës. Të dhënat e rezultateve për këto komponentë lënë të kuptohet se nuk ka asnjë dallim gjinor bazuar në këto komponentë, ose ndonjë tjetër. Edhe pse, nuk rezultoi të kishte asnjë dallim të rëndësishëm statistikor ndërmjet nxënësve femra dhe atyre

meshkuj në shkollat e mesme në aspekte që lidhen me mësimin e lëndës së fizikës thelbësisht e motivuar, të dy kategoritë e nxënësve, femra dhe meshkuj rezultuan mesatarisht thelbësisht të motivuar në mësimin e lëndës së fizikës. Të dy kategoritë, nxënësit femra dhe ata meshkuj të shkollave të mesme kishin besim të moderuar në të mësuarit e lëndës së fizikës, lidhje të moderuar për të mësuar lëndën e fizikës për qëllimet e tyre personale, dhe përgjegjësi të moderuar në mësimin e fizikës.

Rezultatet nënkuptojnë se disa ndryshime të rëndësishme duhet të bëhen në programet mësimore në shkollat e mesme, duke marrë në konsideratë motivimin e nxënësve, në mënyrë që të arrihen përmirësime në motivimin e nxënësve të shkollave të mesme për të mësuar lëndën e fizikës. Ndërsa në mësimin e lëndës së fizikës, është e rëndësishme që t'i kushtohet vëmendje nevojave të nxënësve femra dhe nxënësve meshkuj respektivisht.

Studimet për aspektin që ka të bëjë me ankthin tregojnë se nxënëset femra janë përgjithësisht më të shqetësuara në lidhje me lëndën e fizikës dhe vlerësimin në lëndën e fizikës (nota). Teknikat e reduktimit të ankthit në lëndën e fizikës duhet të hulumtohen në mënyrë që të zvogëlohet ankthi i të mësuarit të lëndës së fizikës tek nxënëset femra.

Nxënësit meshkuj në shkollat e mesme ndihen më të sigurt në aftësitë e tyre për të qenë të suksesshëm në lëndë si ajo e fizikës në krahasim me nxënëset femra të shkollave të mesme. Për të rritur me vetë efikasitetin tek nxënëset femra, duhet të hulumtohen dhe zhvillohen teknika të veçanta. Nxënëset femra janë më të motivuara për të mësuar lëndën e fizikës, në rastet kur ata e kuptojnë se fizika është e lidhur me qëllimet e tyre personale. Prandaj, ideja se “fizika është i dobishme”, duhet të shprehet nëpërmjet shembujve, ngjarje dhe aspekte që lidhen me jetën e vërtetë. Edhe pse nuk kishte dallim të rëndësishëm statistikor në të mësuarit të fizikës të motivuar nga faktorë të jashtëm mes nxënësve meshkuj dhe atyre femra të shkollave të mesme, madhësia e efektit ishte i vogël (ajo ishte vetëm 0,011). Të dy kategoritë, nxënëset femra dhe meshkuj të shkollave të mesme rezultojnë më të motivuar në rastet kur stimulohen nga çmimet, notat, etj. edhe pse është e rekomanduar zakonisht që të mos përdoren stimuj motivues motivimi i jashtëm gjatë gjithë kohës gjatë mësimin. Sigurisht që nxënësit mund të jenë të motivuar në thelb ose të motivuar nga faktorë të tjerë, pasi motivimi mund të ekzistojë tek vetë nxënësit në nivele të ndryshme (Vallerand, 2002).

Prandaj, të dy mënyrat e motivimit në faktorë thelbësore dhe faktorë të jashtëm sugjerohen të aplikohen në mësimdhënien e lëndës së fizikës. Rrjedhimisht, nëse aktivitetet motivuese merren në konsideratë, do të kishim mësuar më të motivuar për mësimin e lëndës së fizikës dhe për rrjedhojë nxënës të motivuar për të mësuar lëndën e fizikës.

Appendix I

Science Motivation Questionnaire (SMQ)

©2005 Shawn M. Glynn and Thomas R. Koballa, Jr.

In order to better understand what you think and feel about your college science courses, please respond to each of the following statements from the perspective of:

“When I am in a college science course...”

01. I enjoy learning the science.

Never Rarely Sometimes Usually Always

02. The science I learn relates to my personal goals.

Never Rarely Sometimes Usually Always

03. I like to do better than the other students on the science tests.

Never Rarely Sometimes Usually Always

04. I am nervous about how I will do on the science tests.

Never Rarely Sometimes Usually Always

05. If I am having trouble learning the science, I try to figure out why.

Never Rarely Sometimes Usually Always

06. I become anxious when it is time to take a science test.

Never Rarely Sometimes Usually Always

07. Earning a good science grade is important to me.

Never Rarely Sometimes Usually Always

08. I put enough effort into learning the science.

Never Rarely Sometimes Usually Always

09. I use strategies that ensure I learn the science well.

Never Rarely Sometimes Usually Always

10. I think about how learning the science can help me get a good job.

Never Rarely Sometimes Usually Always

11. I think about how the science I learn will be helpful to me.

Never Rarely Sometimes Usually Always

12. I expect to do as well as or better than other students in the science course.

Never Rarely Sometimes Usually Always

13. I worry about failing the science tests.

Never Rarely Sometimes Usually Always

14. I am concerned that the other students are better in science.
 Never Rarely Sometimes Usually Always
15. I think about how my science grade will affect my overall grade point average.
 Never Rarely Sometimes Usually Always
16. The science I learn is more important to me than the grade I receive.
 Never Rarely Sometimes Usually Always
17. I think about how learning the science can help my career.
 Never Rarely Sometimes Usually Always
18. I hate taking the science tests.
 Never Rarely Sometimes Usually Always
19. I think about how I will use the science I learn.
 Never Rarely Sometimes Usually Always
20. It is my fault, if I do not understand the science.
 Never Rarely Sometimes Usually Always
21. I am confident I will do well on the science labs and projects.
 Never Rarely Sometimes Usually Always
22. I find learning the science interesting.
 Never Rarely Sometimes Usually Always
23. The science I learn is relevant to my life.
 Never Rarely Sometimes Usually Always
24. I believe I can master the knowledge and skills in the science course.
 Never Rarely Sometimes Usually Always
25. The science I learn has practical value for me.
 Never Rarely Sometimes Usually Always
26. I prepare well for the science tests and labs.
 Never Rarely Sometimes Usually Always
27. I like science that challenges me.
 Never Rarely Sometimes Usually Always
28. I am confident I will do well on the science tests.
 Never Rarely Sometimes Usually Always
29. I believe I can earn a grade of "A" in the science course.
 Never Rarely Sometimes Usually Always
30. Understanding the science gives me a sense of accomplishment.
 Never Rarely Sometimes Usually Always
- The End Thank you

Appendix II

Motivues për Fizikën

In order to better understand what you think and feel about your physics courses, please respond to each of the following statements from the perspective of: "When I am in a physics course..."

Për të kuptuar më mirë se çfarë mendoni dhe ndjeni rreth lëndës së fizikës në shkollë, ju lutem përgjigjuni secilit nga pohimet e mëposhtme nga këndvështrimi: "Kur jam në një orë mësimi Fizike..."

	Never	Rarely	Sometimes	Usually	Always
When I am in a physics course					
Kur jam në një orë mësimi Fizike					
← I enjoy learning the physics. Mua më pëlqen të mësoj fizikë.					
← The physics I learn relates to my personal goals. Fizika që mësoj ka lidhje me qëllimet e mia.					
← I like to do better than the other students on the physics tests. Më pëlqen të dal më mirë se nxënësit e tjerë në testet e fizikës.					

When I am in a physics course Kur jam në një orë mësimi Fizike	Never/Kurrë	Rarely/Rralëherë	Sometimes/Ndonjëherë	Usually/Zakonisht	Always/Gjithmonë
← I am nervous about how I will do on the physics tests. Jam i shqetësuar se si do të dal në testet e fizikës.					
← If I am having trouble learning the physics, I try to figure out why. Nëse kam probleme me mësimin e fizikës, përpiqem të gjej shkakun.					
← I become anxious when it is time to take a physics test. Përrjetoj ankth kur afron koha për të kryer testin e fizikës.					
← Earning a good physics grade is important to me. Për mua është e rëndësishme të marr një notë të mirë në fizikë.					
← I put enough effort into learning the physics. Unë përpiqem mjaftueshëm për të mësuar fizikën.					
← I use strategies that ensure I learn the physics well. Unë përdor strategji që më sigurojnë të mësoj mirë fizikën.					
← I think about how learning the physics can help me get a good job. Unë mendoj se si të mësuarit të fizikës mund të më ndihmojë të gjej një punë të mirë.					
← I think about how the physics I learn will be helpful to me. Unë mendoj se si të mësuarit të fizikës do të më ndihmojë.					
← I expect to do as well as or better than other students in the physics course. Unë pres të jem të paktën aq i suksesshëm apo më mirë se sa nxënësit e tjerë në fizikë.					
← I worry about failing the physics tests. Më shqetëson ideja e ngeles në testet e fizikës.					
← I am concerned that the other students are better in physics. Jam i shqetësuar që nxënësit e tjerë janë më mirë në fizikë.					
← I think about how my physics grade will affect my overall grade point average. Mendoj se si nota ime e fizikës do të ndikojë në mesataren time të përgjithshme.					
← The physics I learn is more important to me than the grade I receive. Ajo çfarë mësoj nga fizika është më e rëndësishme për mua sesa nota që marr.					
← I think about how learning the physics can help my career. Unë mendoj se si të mësuarit të fizikës mund të më ndihmojë në karrierën time.					
← I hate taking the physics tests. Unë i urrej testet e fizikës.					
← I think about how I will use the physics I learn. Mendoj se si do ta përdor fizikën që mësoj.					
← It is my fault, if I do not understand the physics. Është faji im nëse nuk e kuptoj fizikën.					
← I am confident I will do well on the physics labs and projects. Jam i bindur se do të dal mirë në laboratorët dhe projektet e fizikës.					
← I find learning the physics interesting. Më duket interesante të mësuarit e fizikës.					
← The physics I learn is relevant to my life. Fizika që mësoj ka lidhje me jetën time.					
← I believe I can master the knowledge and skills in the physics course. Une besoj se mund t'i zotëroj dijet dhe aftësitë në lëndën e fizikës.					
← The physics I learn has practical value for me. Fizika që mësoj ka vlera praktike për mua.					
← I prepare well for the physics tests and labs. Unë për gatitem mirë për testet dhe laboratorët e fizikës.					
Ditët e Studimeve Shqiptare / 2015					

	Never/Kurrë	Rare/Realisht	Sometimes/Ndonjëherë	Usually/Zakonisht	Always/Gjithmonë
When I am in a physics course Kur jam në një orë mësimi Fizike					
← I like physics that challenges me. Më pëlqen fizika që më sfidon.					
← I am confident I will do well on the physics tests. Jam i bindur se do të dal mirë në testet e fizikës.					
← I believe I can earn a grade of 10 in the physics course. Kam besim se mund të marr 10 në lëndën e fizikës.					
← Understanding the physics gives me a sense of accomplishment. Të kuptuarit e fizikës më jep një ndjenjë plotësimi.					

Bibliografia

- Akbas, A. & Kan, A. (2007). Affective factors that influence chemistry achievement (Motivation and Anxiety) and the power of these factors to predict chemistry achievement-II. *Journal of Turkish Science Education*, 4 (1), 10-19.
- Çetin-Dindar, A., & Geban, Ö. (2010). The Turkish adaptation of the science motivation questionnaire. *Contemporary Science Education Research: Pre-Service and In Service Teacher Education*, 119-127
- Alderman, M. K. (2004). *Motivation for Achievement: Possibilities for Teaching and Learning* (2nd ed.). Mahwah, NJ: Lawrence Erlbaum Associates.
- Bandura, A. (1989). Social Cognitive Theory. In R. Vasta (Ed), *Annals of child development* (Vol. 6, pp. 1-60). Greenwich, CT: JAI Press.
- Britner, S. L. & Pajares, F. (2001). Self-efficacy beliefs, motivation, race, and gender in middle school science. *Journal of Women and Minorities in Science and Engineering*, 7, 271-285.
- Debacker, T. K. & Nelson, R. M. (2000). Motivation to Learn Science: Differences Related to Gender, Class Type, and Ability. *The Journal of Educational Research*, 93 (4), 245-54.
- De Boer, G. A. (2000). "Scientific Literacy: Another Look at Its Historical and Contemporary Meanings and Its Relationship to Science Education Reform". *Journal of Research in Science Teaching*, 37 (6), 582-601.
- Entwistle, N. (1986, April). *Approaches to learning in higher education: Effects of motivation and perceptions of the learning environment*. Paper presented at the Annual Meeting of the American Educational Research Association, San Francisco, CA.
- Ergül, H. (2006). "Çevrimiçi Eğitimde Akademik Başarıyı Etkileyen Güdülenme Yapıları". *The Turkish Online Journal of Educational Technology*, 5 (1), 13.
- Ersoz, F. A. Science Motivation Questionnaire [Fen Bilimleri Motivasyon Anketi]. Retrieved November 9, 2007, from <http://www.coe.uga.edu/smq/turkish.pdf>
- Field, A. (2000). *Discovering statistics using SPSS for Windows*. London: Sage Publications.
- Fraenkel, J. R. & Wallen, N. E. (2003). *How to Design and Evaluate Research in Education*. New York, NY: the McGraw-Hill Companies, Inc.
- Gaither, C. G. & Cavasos-Gaither, A. E. (2002). *Chemically speaking: A dictionary of quotations*. Bristol: Institute of Physics.
- Glynn, S. M. & Koballa, T. R., Jr., (2006). Motivation to learn science. In Joel J. Mintzes and William H. Leonard (Eds.) *Handbook of College Science Teaching* (pp. 25-32). Arlington, VA: National Science Teachers Association Press.
- Glynn, S. M., Taasobshirazi, G. & Brickman, P. (2007). Nonscience majors learning science: A theoretical model of motivation. *Journal of Research in Science Teaching*, 44 (8), 1088-1107.
- Glynn, M.S., Taasobshirazi, G. & Brickman, P. (2009). "Science Motivation Questionnaire: Construct Validation with Nonscience Majors". *Journal of Research in Science Teaching*, 46 (2), 127-146.
- İlhan, N., Yıldırım, A., & Yılmaz, S. S. (2012). Kimya Motivasyon Anketi: Geçerlik Ve Güvenirlik Çalışması. *Mustafa Kemal University Journal of Social Sciences Institute*, 297-310.
- Jacobsen, D.A., Eggen, P., & Kauchak, D. (2002). *Methods for Teaching, Promoting Student Learning* (Sixth Ed.). New Jersey: Meririll Prentice Hall.
- Joreskog, K. G., & Sörbom, D. (1993). *LISREL8 User's Reference Guide*. Chicago: Scientific Software International, Inc.
- Mallow, J. (2006). Science Anxiety: Research and Action. In Joel J. Mintzes and William H. Leonard (Eds.) *Handbook of college science teaching* (pp.3-14). Arlington, VA: National Science Teachers Association Press.
- Mallow, J. (1994). Gender-related science anxiety: a first binational study. *Journal of Science Education and Technology*, 3 (4), 227-238.
- Meece, J. L. & Jones, M. G. (1996). Gender differences in motivation and strategy use in science: Are girls rote learners? *Journal of Research in Science Teaching*, 33(4), 393-406.
- Pintrich, P. & Schunk, D. (2002). *Motivation in Education: Theory, Research & Applications* (2nd ed.). Upper Saddle River, New Jersey: Pearson Education, Inc..
- Pintrich, P. R., Marx, R. W., & Boyle, R. A. (1993). Beyond cold conceptual change: The role of motivational beliefs and classroom contextual factors in the process of conceptual change. *Review of Educational Research*, 63(2), 167-199.
- Reveles, M.J., Cordova, R., & Kelly, G. J. (2004). "Science Literacy and Academic Identity Formulation". *Journal of Research in Science* "Transformimi i

Teaching, 41 (10), 1111-1144.

Schunk, D. H. (2001). "Self-Regulation Through Goal Setting". (ERIC Digest (CG-01-08).

Singh, K., Granville, M., & Dika, S. (2002). Mathematics and science achievement: Effects of motivation, interest, and academic engagement. *The Journal of Educational Research*, 95 (6), 323-332.

Tabachnick B. G. & Fidell, L. S. (2001). *Using Multivariate Statistics* (4th ed.). Needham Heights, MA: Allyn & Bacon.

Tegmark, M. (2015). *Our Mathematical Universe: My Quest for the Ultimate Nature of Reality*. Knopf Doubleday Publishing Group.

Vallerand, R. J. (2002). Intrinsic and extrinsic motivation: a hierarchical model. In Edward L. Deci and Richard M. Ryan. *Handbook of self-determination research* (37-63). Rochester, NY: the University of Rochester Press.

Zusho A., Pintrich P. R. & Coppalo, B. (2003). Skill and will: the role of motivation and cognition in the learning of college chemistry. *International Journal of Science Education*, 25(9), 1081-1094.

Zeyer, A., Bölsterli, K., Brovelli, D., & Oderm, F. (2012). Brain Type or Sex Differences? A structural equation model of the relation between brain type, sex, and motivation to learn science. *International Journal of Science Education*, 779-802.

INTEGRIMI I SHQIPËRISË NË BE; PËRFITIMET DHE PENALITETET NË ASPEKTIN E IDENTITETIT KOMBËTAR

HAZBI LIKA

Doktorant në UET në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Pedagog në Universitetin Aleksandër Moisiu, Durrës

ABSTRAKT

Integrimi evropian si projekt politik natyrisht ka dhënë dhe vazhdon të japë impaktet e veta në sfera të rëndësishme të jetës së këtij komuniteti shumëkombësh që e popullon kontinentin e vjetër. Sfera ekonomike, ajo institucionale, vendimmarrja dhe legjitimiteti janë tema debati të përditshme dhe ka hulumtime shkencore në këto fusha pasi janë më të ndjeshme dhe të prekshme në jetën e këtij komuniteti. Studimet për këto çështje janë të matshme dhe emperikisht të provueshme. Kurse në lëmin e kulturës, këto studime janë hapa prapa dhe ato që pak janë, janë të vështira për tu verifikuar dhe për tu provuar si të vërteta, pasi operojnë në sferën abstrakte të mendimit dhe të perceptimit. Nëse në aspektin ekonomik, kostoja dhe përfitimet e integrimit të Shqipërisë, maten në njëfarë mënyre dhe përkthehen në shifra, nëse sovraniteti i shtetit tonë tkurret në raport me numrin e vendimmarrjeve që u transferohen institucioneve të BE-së, shtrohet pyetja se çfarë ndodh me ne në aspektin e identitetit tonë kombëtar? Pra vijon pyetja se do të pasurohet më shumë në kuadrin e integrimit, identiteti ynë kulturor, apo do të kemi më shumë penalitete për shkak të integrimit? Në aspektin identitar, sa dhe si do jetë kjo kosto për shkak të këtij kooperimi politik? Po përfitimet dhe favorizimet si do t'i marrim konkretisht? A do të jetë identiteti ynë më i imunizuar nga trendet kulturore të Globalizimit duke qenë brenda BE-së apo do të bëhet lehtësisht më i prekshëm? Pra e thënë ndryshe kur të pyetemi nesër se a e ndjemë veten më shumë shqiptarë dhe më pak evropian, apo më shumë evropian dhe më pak shqiptarë, kush do të jetë përgjigjja? Këto janë çështjet që ngenë aksin kryesor të kësaj kumtese dhe që premtoj tu jap përgjigje pa çfarë se kjo përgjigje në këtë kumtesë do të ngelet brenda stadiit hipotetik, dhe me siguri me studimin tim doktorial që po vazhdoj në këtë linjë do të jenë të provuara me të dhëna dhe me shifra konkrete.

Fjalë kyç: *Identitet kulturor; Bashkim Evropian; Ideologji unifikuese; trend global; sovranitet kombëtar.*

Hyrje

Kjo kumtesë do të vendoset në hullinë e vet, nëse fillimisht do të përpiqemi të shpjegojmë se ç'kuptojmë me fjalën identitet, pastaj të përkufizojmë me pak fjalë identitetin europian dhe të formulojmë qasjet tona për identitetin tonë kulturor. Me pak fjalë, me identitet nënkuptojmë veçantitë apo tiparet që ka një send, të cilat nuk ndeshen si të tilla në sendet e tjera. Në gjirin e shoqërisë njerëzore çdo hallkë e saj ka identitetin e vet, i cili mund të jetë fizik, moral, kulturor, juridik e politik. Kështu për shembull, njeriu, si qenie humane dhe shoqërore, ka si tipar themelor identitetin fizik, në vështrimin antropologjik, ka veçori personale që nuk ndeshen të gjitha së bashku tek qeniet e tjera: emri, mbiemri, vendlindja, datëlindja, atësia, amësia, seksi, lartësia trupore, ngjyra e lëkurës, e flokëve, e syve, defektet fizike dhe kohët e fundit shenjat e gishtërinjve ose shenjat biometrike. Në të njëjtën kohë si qenie shoqërore ka edhe identitetin e vet kulturor e qytetar, me të cilin nënkuptohen: gjuha amtare, një memorie historike e përbashkët, disa simbole me të cilët identifikohet, përkatësia etnike, deri diku qytetaria shtetërore, (pasi kjo e fundit është subjekt i ndryshimeve të shpeshta), në disa raste (por jo kurdoherë) edhe përkatësia fetare (në rastet kur manifestohen me të sentimentet etnike). Njeriu, si qenie humane ka një prirje natyrale të dyfishtë: të jetë identitet në vetvete, por në të njëjtën kohë, kërkon që të identifikohet me një entitet shoqëror sa më të madh ku jeton në një territor të kufizuar, me një memorie historike dhe mite origjine të përbashkëta, me një kulture popullore dhe publike të standardizuar, me të njëjtat ligje të pashkruara, brenda një mobilimi ekonomik dhe territor të përbashkët, me të drejta dhe detyrime ligjore të njëjta për të gjithë anëtarët e kolektivit. Me pak fjalë kjo pranohet deri diku si përkufizimi klasik për identitetin kombëtar. Kjo mënyrë perceptimi e konceptit të identitetit në përgjithësi dhe atij kombëtar në veçanti natyrshëm shtron pyetjen: a mund të flasim për identitet kulturor europian? A ka Europa sot një identitet të vetin që është i veçantë nga të tjerët? Nëse po për çfarë lloj identiteti bëhet fjalë? Nëse jo pse nuk ka një identitet të vetin? Pasi të trajtohet kjo çështje do hulumtohet më tej për ti dhënë përgjigje pyetjes: po identiteti ynë kombëtar është apo nuk është europian apo është disi si lara-lara (manifeston njëhershëm tiparet e qytetërimit perëndimor edhe lindor)? Pastaj do të rrekemi për ti dhënë përgjigje tezes se do të mbushet apo do të zbrazet përmbajtja e kuptimit të identitetit tonë brenda projektit politik europian? Në vijim vjen pyetja: a do ta dobësojë apo do ta forcojmë identitetin tonë në kuadrin e këtij projekti? me fjalë të thjeshta nesër si pjesë e gjithë institucioneve politike europiane a do të ndjehem më shumë europian apo kështu siç jemi?

Qëllimi i studimit

Qëllimi themelor i kësaj kumtese është të provojë aq sa më lejon natyra e këtij punimi faktin se integrimi I Shqipërisë në Europën e Bashkuar do ti ofrojë avantazhe dhe përfitime identitetit tonë kombëtarë, po penalitete, ku dhe si konkretisht? Në vijim të kësaj logjike do të konstruktojmë aksin qendror ku ngrihet dhe rrinë hipoteza që pret të verifikohet. Kush do të jenë disa aspekte të identitetit tonë që pritet të avantazhohen dhe ku do të presim penalitete që do të pretendohet për t'ju dhënë përgjigje këtyre pyetjeve

Sigurisht hipoteza kryesore do të kërkojë të provojë në vetvete nën/hipoteza të kësaj natyre; 1- Shqipëria e integruar në Europë dhe më demokratike do të jetë më shumë e prirur për të fortifikuar identitetin e vet etnik; 2- Shqipëria më pak sovranë për shkak të integritetit në Europë do të do të jetë po aq e kufizuar për të ushtruar sovranitetin e vet në funksion të mbrojtjes së identitetit kulturor? 3- A do të dimë ne të bëjmë akomodim kulturor të identitetit tonë kombëtar brenda identitetit europian? Këto hipoteza që ngrihen të cilat nuk mund të marrin përgjigjen e plotë brenda kësaj kumtese, natyrshëm shtrajnë fillimisht hullinë e studimit në kahun e asaj për të përcaktuar kuptimin e nocionit- identitet, për ta përshkallëzuar më tej këtë kuptim në nivelin e identitetit europian dhe identitetin kombëtar. Që të pretendojmë për të ezauruar më tej këtë pohim, në fillim do rrekemi për të ofruar panoramën e debateve kryesisht të autorëve tanë rreth çështjeve: A ka Europa një identitet të vetin kulturor? Po identiteti ynë si është, a është europian apo lara-lara? Duhet ta bëjmë identitetin tonë ndryshe, apo t'ia tregojmë Europës kështu siç e kemi? Pra identiteti ynë është në të vërtetë europian, apo më shumë shitet si I tillë?

Korniza e debateve mbi identitetin tonë dhe raportet me atë europian

Nuk do të merrem shumë në këtë kumtesë me debatet e studiuesve serioz që ndjekin hap pas hapi proceset e integritetit europian dhe ofrojnë këndvështrimet e tyre për të ardhmen e Europës kulturore, këtu do të mjaftohem vetëm me disa qasje të autorëve shqiptarë që kanë diskutuar çështjen e identitetit tonë kombëtarë në raport me identitetin europian. Ky do të jetë materiali ku unë do të mbështesë analizën dhe interpretimin tim, në favor të hipotezës që ngre dhe mbroj.

Fusha e këtij debati është e gjerë dhe ka ndezur polemika të gjata, por unë do të fokusohem vetëm në komponentin identitar të kulturës. Jo se nuk është diskutuar edhe më parë një çështje e tillë gjatë këtij tranzicioni shqiptar, por personat që e hapen këtë temë nuk kishin peshën dhe influencë dominuese në opinionin publik shqiptar. Debati ndizet kur shkrimtari i mirënjohur I. Kadare boton esenë e tij; "Identiteti Europian I Shqiptarëve" që kjo menjëherë provokoi reagimet e Akademikut Rexhep Qose në Kumtesën e tij "Realitet i Shpërfillur" I. Kadare në veprën e tij në mënyrë kategorike pranon se Europa ka një identitet kulturor të saj dhe në themel të këtij identiteti vendos krishtërimin Perëndimor. Kadare i ka qëndruar vazhdimisht kësaj linje dhe e mbron këtë në mënyrën e tij duke e lidhur identitetin tonë me identitetin europian me anë të krishtërimin. Ismail Kadare në esenë e vet me titull "Identiteti Evropian i Shqiptarëve", (botuar nga "Onufri", Tiranë 2006), i vë një theks

të tepruar komponentit fetar, qoftë i krishterë, qoftë mysliman, kur flet për identitetin shqiptar të shekujve të kaluar. Ai pohon se për një kohë të gjatë identiteti kombëtar shqiptar u gatua duke patur si komponent fenë e krishterë. Me këtë komponent fetar, shqiptarët sipas tij, kishin një identitet të plotë “europian”. Por më vonë, (po sipas tij) me pushtimin osman të Shqipërisë, kur feja islame e diktuar nga Perandoria e Gjysmëhënës për interesat e saj politike zëvendësoi fenë e krishterë si përbërëse në identitetin kombëtar të shumicës së popullsisë shqiptare, identiteti i tyre “evropian” u dëmtua. Në një farë mënyre Kadare, këtu del kontraditor me vetveten, pasi në njërin anë komponentin fetar (në këtë radhë krishtërimin) e shikon si element substancial në ngjizjen e identitetit kombëtar, kurse në anën tjetër religjionin islam e quan si deformues të genit që mban identitetin kulturor të kombit tonë. Ndryshe mendon Rexhep Qose. Në polemikën me Ismail Kadarenë, pikëpamjet e veta në këtë çështje i ka parashtruar në tri broshura të botuara njëra pas tjetrës – “Realiteti i shpërfillur”, “Ideologjia e shpërbërjes”, “Të vërtetat e vonuara” (Toena 2006). Edhe Rexhep Qose pranon se dikur identiteti kombëtar shqiptar ishte gatuar duke patur si komponent fenë e krishterë. Ai pranon gjithashtu, se feja islame u përqaftua nga shumica e shqiptarëve gjatë shekujve të sundimit osman. Por, ndryshe nga Ismail Kadare, ai ngul këmbë se fetë, ritet, dhe sektet fetare pa dallime (islamizmi, ortodoksia, katolicizmi), ndërhyjnë në identitetin kombëtar të shqiptarëve duke u integruar aq thellë, sa edhe në ditët tona janë përbërës të tij. Në këtë pohim, Qose qëndron më afër logjikës së studiuesit duke ju ruajtur retorikave populiste. Edhe studiuesi Aurel Plasari në veprën e tij “Rrëmbimi i Europës” pohon se Europa ka një identitet të vetin dhe këtë e lidh me krishtërimin në përgjithësi. Për këtë Plasari shkon edhe më tej duke ju referuar poetit dhe mendimtarit Paul Valery në esenë e tij me titull: “La crise de l’esprit” të pranuar deri diku si Manifesti Europian. Sipas Valerysë: Europa ekziston aty ku zotëron ndikimi i besimit të krishterë, i botës latine dhe i letërsisë helene. Pra sipas tij: as bota greke vetëm, as ajo latine vetëm, pa krishtërimin nuk kanë mundur të konstituojnë Europën. Nuk lë pa cituar edhe poetin gjerman Gëte që mendonte se çfarë e bashkon Europën është kultura dhe çfarë e ndanë, janë idetë politike. Plasari shkon deri aty sa edhe themeluesit e Europës së Bashkuar i konsideron politikan dhe mendimtarë me orientim dhe besim të krishterë si, De Kasperin, Adenaurin, Shuman, Monnet, Speaak. Po sipas Plasarit: është fakt që shekuj me radhë kultura europiane ka qënë e frymëzuar nga Shpirti i Shenjtë dhe nga shpirtërorësia e krishtere; fakti që demokracia sipas parimit bergsonian ka një thelb ungjillor dhe ka si forcë shtytëse dashurinë e tij. Po sipas Plasarit, Europa nuk është thjesht konstrukt gjeofizik, por pikësëpari është strukturë kulturore që është blatur nga fryma ungjillore dhe e bën Europen të ketë një identitet të vetin. Plasari nuk pohon se në ç’raport është identiteti ynë kombëtar me historinë e krishtërimin dhe me islamizmin, vetëm se aprovon hipotezën e ngritur nga studiues të tjerë; “krishtërimi është bërë në Europë si refuzim i Islamit”. Nuk mendon kështu studiuesi i historisë Kristo Frashëri. Pikë së pari Kristo Frashëri e përjashton religjionin si element të rëndësishëm të identitetit kulturor, dhe rrallë e pranon si element të tillë, vetëm në rastet kur ky religjion reflekton nuancë etnike, si p.sh tek polaket dhe irlandezet të qenurit katolik plotëson më shumë identitetin etnik të tyre. Frashëri në polemikën e tij; “Të metat e debatit Qose- Kadare” botuar në vitin 2006 në shtypin e asaj periudhe mbron pikëpamjen se Kontinenti Evropian nuk ka një identitet kulturor dhe qytetar të përcaktuar. Ai përbëhet nga një larmi identitetesh kulturore dhe qytetare kombëtare, nga të cilët asnjëri nuk mund të përfaqësojë identitetin kulturor dhe qytetar të Kontinentit. Edhe në këtë rast, identiteti kulturor dhe qytetar i çdo kombi evropian është në raport me atë që do të ishte identiteti kulturor evropian, si pjesa me të tërën. Shkurt, Europa si continent, nuk ka asnjë identitet të mirëfilltë kulturor e qytetar të saj. Nëse nga kjo pikëpamje duhet të flasim për një identitet të mirëfilltë kulturor e qytetar evropian, -shprehet Frashëri- këtë duhet ta kërkojmë tek mungesa e një identiteti të mirëfilltë evropian. Edhe Jurgen Habermas në librin e tij: “Ah Europë” përkthyer nga gjermanishtja në Shkup 2011 mendon që Europa sot nuk ka një identitet të vetin, dhe i quan të kota rrekjet për të krijuar një identitet të përbashkët kulturor evropian, pasi Europa as nuk e ka patur as nuk e ka një identitet të mirëfilltë të vetin, dhe kjo do të ishte një shantazh semantik për një numër popujsh që janë margjinat e qytetërimit perëndimor evropian dhe shpreh besimin se Europa e Bashkuar shumë mund të krijoj një opinion të përbashkët evropian dhe jo një identitet të vetëm, kjo është e pamundur pasi i mungon baza historike. F. 110.

Retorikat populiste janë të pa mjaftueshme për të përcaktuar identitetin tonë kombëtar

Përveç përkufizimeve tjera që rëndom përdoren për ti dhënë kuptimin kombit vjen edhe kuptimi në këndvështrimin sociologjik, ku kombi paraqitet si vizioni më potent i ideologjisë për manifestim të identitetit individual dhe kolektiv. Nevoja për të manifestuar identitet kolektiv dhe individual i jep identitetit konstrukt social dhe e bën veten të dallohet nga të tjerët dhe në të njëjtën kohë të identifikohet në grupime sa më të mëdha. Ky është aspekti psikologjik dhe social që kombet pavarësisht orientimeve kulturore kanë një komponent unikal në themelet e tyre. Ndonëse në disa pikëpamje duken uniform nuk është se janë të njëjtë të gjithë. A. Smith dhe E. Kondure janë përpjekur të bëjnë klasifikimin e llojeve të nacionalizmave sipas orientimeve kulturore. Që të dy bien dakord për faktin që nacionalizmi është produkt i rrethanave dhe përvojave historike të popujve të ndryshëm dhe për këtë arsye pranojnë dy lloj nacionalizmash: nacionalizmin Perëndimor dhe atë Lindor.

Dhe konkretisht dy modelet kanë emërtim gjeografik, por në fakt janë me orientim kulturor dhe mbahen brenda këtyre përkufizimeve. Modeli i kombit Perëndimor, ka një qendër territori, një komunitet politik, një sistem ligjor të përbashkët, barazinë e qytetarëve para ligjit, dhe një shoqëri civile. Përkundrajt këtij ngrihet modeli Lindor i kombit; “Ky lloj kombi niset nga konstrukt gjenologjik, është më tepër i prokuper për përbajtjen etnike dhe lidhjet kulturore, thekson elementet popullore dhe folklorike, kërkon pa fund rrënjët e folkut, traditat, zakonet, gjuhen, religjionin, ritualet, rizbulon intelektualët urban, si filologë, historianë, folkloristë etnografë, linguistë etj.

← Aurel plasari “Rrëmbimi i Europës” f. 84 shtëpia botuese 55 - 2005

Në një farë mënyre këtë lloj klasifikimi do ta marrim me rezervë dhe është lehtësisht I atakueshëm, pasi ndarja midis këtyre nacionalizmave nuk është si me thikë, dhe aq më tepër për faktin se entitetet etnike nuk është se linden dhe mbeten kategori statike, ato kanë përjetuar periudhat e transformimeve dhe transfuzioneve të formës dhe të përmbajtjes në kohë dhe në hapësirë, kanë patur dhe kanë ciklet historike dhe "biologjike" të zhvillimit dhe për këtë arsye ndodh që tiparet e njërit mund të shfaqen tek tjetri dhe anasjelltas, por deri diku një përkufizim i tillë qëndron dhe ja vlen të bësh qasje korrekte ndaj tyre.

Duke ju referuar përkufizimit klasik të dhënë nga dy autorët e mësipërm, nuk mund të shmanget kurioziteti se në cilin etnitet etnik qëndron nacionalizmi ynë? I përkasim nacionalizmit Perëndimor apo atij Lindor, apo një lloj entiteti që shfaq herë tiparet e njërit dhe herë tiparet e tjetrit? Në fakt ka patur dhe ka qasje ndaj këtij fenomeni dhe studiues tanë dhe të huaj kanë hartuar trajtesa me përmbajtje; "Shqipëria midis Lindjes dhe Perëndimit" dhe a do të thotë kjo se ne si entitet i shfaqim përgjysmë këto dy lloj nacionalizmash? Apo shitemi si Perëndimor kur në fakt për arsye historike, nuk e fshehim kollaj karakterin lindor? Apo tendencat për tu arratisur nga Lindja e quajnë të mjaftueshme për tu vetëquajtur perëndimor? Me siguri kjo kumtesë nuk zotëron hapësirat e duhura për ta provuar plotësisht këtë (ndonëse në një studim tjetër po) pasi duhet të merren në shqyrtim rrethanat historike që kanë prodhuar këto dy lloj kombesh në dy gjysmat e Europës dhe kryesisht në Ballkanin ku ne jetojmë, dhe të mundohemi të jemi korrekt me ato realitete historike që kanë influencuar dukshëm për të determinuar natyrën e kombit tonë. Për hir të vërtetës një debat i tillë për natyrën e kombit tonë, ka fillësuar të hershme në mjediset intelektuale dhe akademike shqiptare dhe ende ngjall dhe frymëzon debat sa herë që shkenca çlirohet nga utilitarizmi dhe komercializmi politik. Këto "zënka" fillojnë ne e gërvishtin "shkëlqimin" oriental që në periudhën e Rilindjes Kombëtare kur perandorisë otomane i kërkohej të dorëzonte Ballkanin Perëndimor. Çfarë ndodh në këtë periudhë? Fati i Shqipërisë nuk vendosej nëpër "mexheliset" turke, por në kancelaritë e Europës. Në të njëjtin kohë do të jetë edhe orientimi politik i lidershipit të kohës. Dhe më tej...? Elita intelektuale dhe politike e vendit u hedh menjëherë në "sulm" për të shndërruar gjithë përmbajtjen e identitetit tonë kulturor. Në traktatin politik dhe filozofik të Sami Frashërit "Shqipëria ç'ka qënë ç'është dhe ç'do të bëhet" hidhet baltë mbi kombin turk – "ç'janë turqit? Një komb i egër, të ardhur nga shkretëtirat e Azisë së Veriut, me nga një hosten në dorë. Këto me egërsinë e tyre zunë më të bukurat vende të botës dhe të qytetëruar; dhe si i rropën dhe i dogjën, po i mbajnë sot në të njëjtën egërsi, nën një varfëri dhe në një tirani që tmerron gjithë botën. Në anën tjetër himnizon vlerat dhe qytetërimin europian. Ndërkohë që i njëjti autor pak më parë kishte shkruar traktate himnizuese dhe admirohej në mexheliset turke si ndër hartuesit e enciklopedisë së atij kombi. Nuk rrinte pas edhe Naimi në veprën "Historia e Skënderbeut" ku mbi kombin turk lëshon epitete denigruese. Ndërkohë edhe Çajupi jepte kushttrimin me vjershat e tij për tu çliruar nga robëria shumë shekullore turke. Në këtë linjë pothuajse ishin gjithë Rilindasit deri tek Pashko Vasa ose Vaso Pasha në thirrjen e tij të famshme: "mos ndigjoni kisha e xhamia; feja e shqiptarit asht shqiptaria" (që në fakt mbante dy emra, njërin për karrierë dhe tjetrin si Rilindas siç thotë I. Kadare në veprën "ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe" Në këtë mënyrë gjeopolitika diktonte gjeo-kulturën. Shpëtimi nga Lindja orientale, dhe orientim nga Perëndimi, gjente shpjegim në një metaforë gjeografike që rëndom përdorej në atë kohë; "dielli që lind anej nga perëndon".

Në periudhën e mëvonshme pas pavarësisë në vitet 30-të, vijon ky debat por më i ekuilibruar. Sintagmat themelore-Oriental apo Oksidental?; "Shqipëria midis Lindjes dhe Perëndimit"; "Shqipëria kopsht shkëmborë në Jug-Lindje të Ballkanit", tregojnë se kushttrimet e Rilindjes filluan të zëvendësohen më sintagmën edhe- edhe. Në këtë kohë periudha ishte më e ftohtë dhe analizat filluan të thellohen në sferën kulturore. Orientimi politik në këtë periudhë ishte thellësisht perëndimore, por ndjesitë e identitetit filluan të përzihen dhe nisen të reflektojnë reminishenca kulturore. Në aspektin konstitucional- monarki kushtetuese, institucione parlamentare dhe qeverisja bëhej me parimet dhe principet kushtetuese europiane. Zogu në sjelljen politike dhe në stilet e jetës mundohet të shfaqej plotësisht perëndimor duke u munduar të fsheh çdo gjë që ishte orientale. Në periudhën e sundimit komunist ndonëse kishte ndonjë belbëzim të vogël nuk pati qasje të tilla. Pas viteve 90- sloganet politike "E duam Shqipërinë si Europa" u priten me brohoritje nga të gjitha qarqet intelektuale dhe akademike me përjashtim të atyre që ishin indoktrinuar nga ideologjia zyrtare e kohës. Çdo gjë lindore u bë e pështire dhe e neveritshme. Përsëri Shqipëria hyri në një inkubator të ri ideologjik duke e shpjeguar të kaluarën e vet dhe të ardhshmen vetëm si pjesë e sferës perëndimore, dhe ashtu ndjehet "mirë" deri nga vitet 2000 kur historian S. Feraj dhe publicisti A. Baleta bëhen zëdhënës të një rryme nacional- islamike duke provokuar qasje të ndryshme ndaj fundamentit tonë kulturor në përgjithësi duke arritur deri tek figura e Skënderbeut. Kjo siç u tha edhe më lart tërhoqi në debat edhe figura të tjera me peshë në jetën publike dhe akademike. Studiuesi Aurel Plasari i vendos shqiptarët para dilemës pa dhënë ndonjë orientim të qartë kulturor me esenë e tij "Vija e Tedosit rishfaqet nga duhet t'ja mbajnë shqiptarët". Në këtë shkrim bën analizë historike, por pa u lodh me argumente për identitetin tonë kombëtar. Në vitin 2006 nis polemika Qose-Kadare pas botimit të esesë së I. Kadarese; "Identiteti Europian i Shqiptarëve". Nga periudha e Rilindjes Kombëtare e deri me sot Shqipëria përjeton një realitet të dyfishtë që në të shumtën e rasteve del si kontradiktore dhe përjashtuese të njëri-tjetrit. Gjatë Rilindjes e deri në fillimet e Luftës së Dytë Botërore, elita drejtuese e vendit u mundua dhe arriti aq sa arriti të ndërtojë perspektivën politike të kombit tonë drejt sferës perëndimore mbi një popull që kishte shekuj I akomoduar politikisht dhe kulturalisht në lindjen bizantine dhe në Orient. Në 50 –vjeçarin e rregjimit të E. Hoxhës përsëri elita drejtuese e vendit e mori dhunshëm kombin tonë duke u munduar të shkatërrojë atë substance kombëtare me identitet perëndimore për ta përfshirë brenda sistemit politik lindor. Në këtë kohë çdo gjë Perëndimore sipas propagandës ishte e huaj dhe e dëmshme për shëndetin e kulturës sonë kombëtare. Pas viteve 90-të gjithë kapitali politik dhe intelektual i yni investohet në funksion të përfshirjes së Shqipërisë në Projektin e Europës së Bashkuar. Europa e Bashkuar është e vetmja alternative për vendin tonë sot dhe të shpikësh alternativë tjetër është marrëzi. Dhe nuk ka asnjë të keqe pse të gjithë fokusohemi për të ngritur perspektivën tonë brenda projektit politik europian, e keqja është se këtë perspektivë të Shqipërisë e ngremë në mënyrë retorike dhe populiste pa qasje korrekte dhe shkencore

në definimin e identitetit tonë kulturor. Kjo është kontradikta e thellë që na mundon sot. Identitetin politik shtetëror tonin e njësojmë me identitetin kombëtar. Kombi dhe shteti janë të ndërthurur me njëri-tjetrin, por janë edhe identitete të ndryshme. Kombi është nocion kulturor, kurse shteti dhe qeverisjet janë nocione politike. Këto dy të fundit influencojnë për ta orientuar një komb drejt një qytetërimi, apo një tjetri, por nuk është e thënë që mund të transformojnë gjithë përmbajtjen kulturore të identitetit të tij. Edhe rilindasit si romantik frymëzuan dhe ngjallen shpresën që populli t'i kthej sytë nga Oksidenti, dhe bënë mjaft punë në këtë drejtim, por kombi ynë për shumë arsye historike një pjesë të mirë të trupit dhe të shpirtit i kishte në orient. Edhe gjatë sundimit të E. Hoxhës elita drejtuese e vendit u mundua ta përfshijë vendin tonë në sferen sllavo-bizantine, por ajo çka u arrit ishte thjeshtë njohje dhe afrim në nivel elitash, jo pajtim kombesh. Kështu perspektiva europiane sot le të na ndihmojë ne për të plotësuar komponentin e kulturës perëndimore që na ka munguar kaq shumë, por kjo nuk do të thotë që ne plotësohemi më mirë në veten tonë duke fshirë ato elemente që me ose pahir janë bërë pjesë e thellë e identitetit tonë.

Identiteti ynë në marrëdhënie me të tjerët

Kur flitet për nacionalizmin bëhet fjalë për të eksploruar një nocion me të cilin identifikohet kulturalisht një komunitet njerëzor. Kombi del si entitet kulturor dhe vazhdon pafundësisht procesin e bërjes së identitetit të vet. Tendencat e natyrshme e këtyre entiteteve është e dyfishtë njëkohësisht; edhe kërkojnë të dallohen nga grupimet tjera, duke thënë se jemi ndryshe, por në anën tjetër kërkojnë të njëjtësohen me grupime sa më të mëdha. Kjo është një prirje natyrale e qenies humane që është zhvilluar vazhdimisht dhe e ka zgjeruar shoqërinë nga rrethet e ngushta fisnore deri në nivel kombesh apo qytetërimesh siç shprehet Hantingtoni. Edhe ne si komb që nuk mund të përjashtohemi nga kjo prirje e natyrshme, në një anë kërkojmë të jemi konstruktivë veçantë gjeologjik. (pellazgë, ilir, shqiptarë) kurse në anën tjetër mundohemi të shpjegojmë se i përkasim sferës së qytetërimit Perëndimor apo Lindor. Për këtë arsye mjedisi intelektual dhe politik në Shqipëri për periudhën që bëhet fjalë, (nga Rilindjes e deri më sot) ushqen polemika për të definuar përmbajtjen kulturore të identitetit tonë. Përveç regjimit të periudhës së E. Hoxhës në pjesën tjetër të kohës pjesa dominuese e elitës drejtuese të vendit mundohet ta shpjegojë kuptimin e identitetit tonë brenda suazës së identitetit kulturor europian. Mirëpo sintagma; “identiteti europian i shqiptarëve” deri më tash përkthehet si njëjtësim i përkatësisë sonë me identitetin kulturor europian dhe si refuzim i identitetit lindor. Të thuash sot që shqiptarët kanë identitet europian kë bërë mirë se shpall një broshurë propagandistike me stil retorik dhe utilitar, por nuk është e thënë se ke shfletuar historinë e kombit tonë me rigorozitet shkencor. Pse ngre këtë pohim? Duke ju referuar Kristo Frashërit dhe shumë studiuesve tjerë europian si Ernest Gellner, Jürgen Habermas, Athina Giddens etj, Europa nuk ka një identitet të vetin kulturor, bile Habermas shkon deri aty sa thotë është e pamundur të bëhet. Edhe themeluesit e Europës së Bashkuar kuptuan pas disa dekadash se projekti politik i tyre, do të ishte i qëndrueshëm po të ishte nisur puna nga Europa kulturore. Kështu që kur Europa nuk ka krijuar deri më sot identitetin e vet kështu nuk kemi se si ne të mjaftohemi me veten duke u identifikuar me të. Megjithatë nuk është ky qëllimi i kësaj kumtese, qëllimi është se ne bëjmë identitetin tonë perëndimor si refuzim total të elementit lindor ku elementet e këtij qytetërimi lindor me mënyra të dhunshme, ose të natyrshme kanë depërtuar në brendësi të jetës shqiptare. Megjithëse edhe perceptimi lindor ngelet mjaft i pa qartë kur merren në shqyrtim këto çështje. Kërkojmë të “arratisemi” nga Lindja, por përsëri nuk shpjegojmë se për cilën Lindje bëhet fjalë; për Lindjen ish komuniste që shtrihet kryesisht në entitetin sllavo-bizantin, apo për orientalizmin me fundament kulturor islamin, apo te dyja përnjëherësh? Të mohosh gjithçka lindore nga cilado Lindje që të vijë nuk mjafton për të përcaktuar dhe formatuar veten nga pikëpamja e identitetit. Vetja bëhet duke pohuar atë që e ke dhe të mundohesh ta transformosh në funksion të perspektivës tënde kombëtare. Kështu t'i ikësh botës lindore ku dominoi sllavo-bizantizmi dhe me vonë komunizmi, përveç të tjerave do të thotë të mohosh nocionin gjeografik dhe administrativ që natyrshëm kanë influencë në bërjen e komponentit kulturor në një entitet të caktuar, kurse të braktisësh lindjen orientale në mënyrë populiste, do të thotë të shprishësh substancën që ka bërë religjionin shpirtëror për komunitetin më të madh në Shqipëri prej 4-5 shekuj. Për arsye madhore fati i Ballkanit do të vihej nën administrimin shtetëror bizantin dhe më vonë nën sundimin otoman, dhe kjo bëri që shqiptarët gjatë periudhës së mesjetës hershme dhe të vonë t'i largohen krishtërit perëndimor. Studiuesi Aurel Plasari e dëshmon kështu këtë fakt; “Në viset arbëre largimi prej sferës shpirtërore e mendore latine që pati zotëruar gjatë mesjetës është zhvilluar nëpërmjet dy procesesh; mbajtjes me kishën lindore dhe myslimanizmit. E gjejmë të regjistruara më së miri këto procese prej relatorëve të Papatit që popullsinë shqiptare e regjistrojnë në tre ndarje: latinë (shqiptarët katolik), skizmatikë (shqiptarë të lidhur me kishën lindore greke dhe sllave) dhe turq (shqiptarë të myslimanizmit). Se në ç' shkallë kishin arritur këto procese fjala vjen në territoret e Kosovës mësohet nga relacioni i Shtjefen Gaspërit, i cili me 1671 numëronte në Dioqezën e Shkupit vetëm 2.169 katolik arbëre që kishin mbetur³. Siç e ka llogaritur edhe S. Driza në vitet 70-të të shekullit XVII nuk kishin mbetur as edhe 1% e popullsisë së Kosovës latinë.⁴ Plasari shkon më tej. Regjimin komunist të E. Hoxhës nuk e shikon si doktrinë politike, por si ideologji që ishte ngritur qëllimisht për të refuzuar Krishtërimin Perëndimor dhe si një mënyrë për t'i ndarë përfundimisht shqiptarët nga ky qytetërim. Dhe sipas tij, po të studiohet me kujdes gjithë sistemi ideologjik i Enver Hoxhës do të kuptohet se antieuropianizimi i tij do të gërshetohej me një kompleks latent antikristian. Plasari mundohet ta provojë këtë supozim duke cituar Hoxhën që i dukej rast i pa precedent për një diktator ateist kur në një fjalim të tij lartësonte Islamizmin dhe denigronte Krishtërimin: “E vërteta është se Kur'ani është më i plotë dhe më i pastër

← ¹Aurel Plasari “Rrembimi i Europes” f. 32 shtepia botuese 55 viti 2005

← ²Po aty, faqe 33

← ³Po aty, f.33

se Bibla e izraelite dhe Ungjilli i të krishterëve”⁵. E pa besueshme për gojën e një marksisti-leninist, ateist- shprehet Plasari. Megjithëse është e vështirë të besohet se sistemi komunist i E. Hoxhës ka qenë projekt politik dhe ideologjik, për të ndarë përfundimisht shqiptarët nga qytetërimi perëndimor, kurse relatorët e Papës mund të kenë bërë gabime të vogla në shifra, por nuk mund të themi që nuk relatojnë fakte dhe dëshmi që njihen mirë nga studiuesit. Ne mund të mblidhemi për t’i kthyer kokëposhtë ato shifra, por nuk mund të mohojmë një të vërtetë që Perandoria e bizantit dhe më vonë ajo otomane e vendosen nën presion elementin shqiptarë kështu që identiteti ynë gjatë asaj periudhe historike është krijuar në marrëdhënie me ta (marrëdhënia do të thotë qoftë si refuzim qoftë si pajtim me ta). Nuk është korrekte dhe shkencore (e di që nuk u shkon përshtat retorikave të romantizmit nacionalist) të pretendosh që identiteti ynë qëndron vetëm në ato elemente të kulturës sonë që kanë ngel të paprekura dhe të pa deformuara nga ky presion i madh. Në sferën kulturore është e paimagjinueshme ta ruash kaq të imunizuar elementin tënd identitar, në një mjedis kaq kompleks social. Teoritë e imunitetit janë të shëndetshme për retorika populiste, por jo argument shkencor i shëndoshë. Identiteti(kolektiv dhe personal) bëhet dhe plotësohet vetëm në marrëdhënie me të tjerët, jashtë këtij konteksti nuk mbahet. Nuk I mjafton vetvetja për të mbijetuar, por vetëm duke hyrë në marrëdhënie me të tjerët, qoftë si refuzim, qoftë si pajtim. I duhet domosdoshmërisht; - I ndryshmi; I kundërti, me të cilin do të masë, të plotësojë, dhe të krahasojë vlerat me të. Ky proces sociologjizmi është I domosdoshëm për identitet personal dhe kolektiv kështu që është e mira edhe ne, ta shikojmë në këtë këndvështrim formimin e identitetit tonë.

Konkluzione

Nga fillimet deri më sot Bashkimi European lexohet dhe përkthehet si projekt politik rajonal dhe nuk dëgjojmë sirena prej tyre që të alarmojnë për të prodhuar domosdoshmërisht një ideologji unifikuuese mbi të cilën do të qëndrojë ky projekt politik. Bashkimi European nuk është as si Roma e vjetër, as si Bizanti dhe as si perandoria osmane, por bashkim vullnetar popujsh që mundohen me mirëkuptim të ndërtojnë të ardhmen e tyre të përbashkët. Deri më tash nuk kemi dëgjuar nga lidhshipi zyrtar as nga institucionet e BE-së shantazh semantik për uniformitet kulturor, as rrafshim të identiteteve etnike. Zyrtarisht preambula e traktatit të Bashkimit European shprehet në ligjëratë të drejtë;

“Bashkimi European do të respektojë larminë e saj të pasur kulturore dhe gjuhësore dhe do të garantojë ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të Evropës.

“Bashkimi do të garantojë përballë kushtetutës barazinë e shteteve anëtare si edhe identitetin e tyre kombëtar që është integruar në strukturat e tyre themelore, politike dhe kushtetuese, përfshirë edhe në autonomitë lokale dhe krahinore.

“Në kuadrin e kësaj kushtetute dhe pa asnjë lloj paragjykimi, pa përfshirë asnjë çështje të veçantë, do të ndalohej çdo diskriminim në fushën e kombësisë”.

“Njerëzit e Evropës, duke krijuar një bashkim më të ngushtë midis tyre, ndodhen përpara alternativës për të pasur një të ardhur paqësore të ndërtuar mbi vlera të përbashkëta. I ndërgjegjshëm për trashëgiminë e tij shpirtërore dhe morale, Bashkimi u themelua mbi vlerat universale të dinjitetit njerëzor: lirisë, barazisë dhe solidaritetit; (Bashkimi) bazohet në parimet e demokracisë dhe të shtetit ligjor; (Bashkimi) e vendos individin në qendër të aktiviteteve të tij, duke krijuar për të (konceptin) e qytetarisë së Bashkimit dhe duke krijuar një hapësirë lirie, sigurie dhe drejtësie. Bashkimi kontribuon për ruajtjen dhe zhvillimin e këtyre vlerave të përbashkëta; ndërkohë respekton larminë e kulturave dhe trashëgimive të popujve të Evropës, si dhe identitetet kombëtare të shteteve anëtare, gjithashtu organizimin e autoriteteve të tyre publike në shkallë kombëtare, krahinore dhe lokale; synon të promovojë zhvillime të balancuara dhe të sigurojë lëvizjen e lirë të personave, shërbimeve, të mirave materiale, të kapitaleve, si edhe lirinë e banesës. Tani për tani është e nevojshme të forcohet mbrojtja e të drejtave themelore nën dritën e ndryshimeve shoqërore, progresit shoqëror, zhvillimeve të teknologjisë dhe të shkencës duke i bërë më të theksuara në këtë Kartë.”

Duket qartë se përmbajta e traktatit nuk ka asnjë çështje për diskriminim kombesh për shkak të identitetit kulturor të tyre, bile shpreh maksimalisht mbrojtjen për minorancat etnike. Bashkimi European nuk ka vendosur ndonjë kriter apo standard për përmbajtjen kulturore të kombeve që aspirojnë BE-në, por anëtarësinë e kushtëzon nga standardet demokratike të një shteti dhe niveli i demokracisë funksionale. Nuk pengon anëtarësimin gjuha, feja, ideologjia, e shkuara dhe tashmja historikë e vendit tonë, por ne na lënë jashtë dyerve të BE-së retorika politike bizantine, feudalizmi politiko-oriental, sundimi fanatik i pushtetit, dhe pse jo në njëfarë mënyre edhe historia jonë që ju ka dashtë disa here të bëhet vitrinë e “hijshme” për politikanët. Kështu, ne me të drejtë aspirojmë të bëhemi pjesë e këtij projekti madhështor politik, dhe shpresojmë të përmirësojmë qeverisjen duke e transferuar një pjesë të saj tek institucionet mbi kombëtarë të BE-së, por Europa e Bashkuar nuk ka lançuar ndonjë projekt madhor kulturor që ne domosdoshmërisht na kërkohet të përshtatim identitetin tonë, deri në njëjtësim me identitetin European. Aq më tepër kur Europa vetë e vuan sot krizën e identitetit në aspektin kulturor dhe një pjesë e mirë e studiuesve e shikojnë të pamundur projektin politik të bashkimit mbi një identitet të përbashkët kulturor. Dhe në logjikën e principeve kryesore mbi të cilat janë hartuar traktatet themeluse të BE-së, siç cituam pak më lart, ne si komb kemi avantazhin e madh pasi BE-ja potencialisht është hapësirë e mjaftueshme lirie ku gjithë popujt të mëdhenj edhe të vegjël zotërojnë mjete juridike dhe politike për të promovuar trashëgiminë kulturore dhe historike të vendit të tij. Pse duhet që ne të vihemi në panik për të zbuluar medoemos rrënjët tona të identitetit vetëm në truallin e krishtërit Perëndimor kur Europa e Bashkuar nuk e kërkon këtë? Europa nuk ka proklamuar ndonjë projekt unifikimi kulturor me fundament të krishterë, kështu që nuk ka arsye që intelektulët tanë të bëhen kasnec të parakohshëm të një projekti të pashpallur. Edhe nëse ndodh një gjë e tillë

nuk na kërkohet ne kontributi për atë projekt, ne do të na kërkohet që brenda këtij projekti të maksimalizojmë përfitimet dhe të shfrytëzojmë gjithë resurset për të plotësuar boshllëkun që i është krijuar trashëgimisë tonë kulturore dhe historike për shkaqe ideologjike (totalitare, apo fetare). Europa e Bashkuar është një avantazh i madh për ne sot, pasi ka brenda saj resursin e pasur të lirisë dhe potencialisht të favorizon që të bësh identitetin etnik pa komplekset historike të shkuarës dhe pa depresion kulturor nga lart. Identiteti ynë kulturor në fillimet e veta kishte konstruktin e vet pagan, vishet më vonë me petkun fetar të Krishtërit Perëndimor, nën administrimin perandorak të Romës dhe nën autoritetin papnor, plotësohet (si refuzim dhe pajtim) me krishtërimin Lindor nën administrimin bizantin dhe po kështu reagon ndaj administrimit osman dhe qytetërimin islam.

Po ta konceptojmë identitetin etnik si diçka të mbyllur dhe të fortifikuar në vetvete, duke menduar që i mjafton vetja do të mundohemi të shpjegojmë kuptimin e tij duke ju vjedhur vetes për tu fshehur njëherë në një qytetërim njëherë në një tjetër (siç rëndom kemi bërë), asnjëherë pa e dëshmuar plotësisht veten. Ndryshe ndodh po ta konceptosh identitetin etnik si nocion që zhvillohet brenda një procesi të hapur, asnjëherë i përfunduar plotësisht, pa e gjetur tamam emrin e vet, por gjithnjë në kërkim dhe me bindjen shkencore se identiteti është here realitet historik apo antropologjik, herë është kuptime të negociuara. Po t'i referohemi kësaj logjike shkencore nuk ka arsye pse ne ti qasemi me inferioritet intelektual projektit politik të Bashkimit Europian. Përfundimisht identiteti etnik nuk është vetëm realitet antropologjik apo konstrukt gjeneologjik, por entitet kulturor që është produkt i procesit të gjatë historik dhe dizenjon profilin identitar të tij në këtë trajektore historike. Secila epokë dhe qytetërim le nuancat e veta brenda nesh dhe identiteti ynë ashtu siç ka aspektet e vetes, krejt të veçanta, ashtu do të reflektojë në të njëjtën mënyrë ato nuancë kulturore që për rrethana historike u ngjizën thellë brenda identitetit tonë. Ata që kanë hartuar projektin politik të Bashkimit Europian, i kanë ditur mirë këto gjëra.

Bibliografia

- Benedict Anderson ; Imagined Communities: Reflections on the Origin and Spread of Nationalism
 BARTH, F., 1969: Ethnic Groups and Boundaries. Boston, Little Brown and Co.
 BILLIG, M., 1995: Banal Nationalism. London,
 BRUBAKER, R., 1992: Citizenship and Nationhood. Cambridge, Mass, Harvard University Press.
 BAUMAN, Z., 1998: Globalization: The Human Consequences. Cambridge, Polity Press
 Eriksen, T. H. (1993). Ethnicity and nationalism: Anthropological perspectives. London: Pluto Press.
 GELLNER, E., 1983: Nations and Nationalism. Oxford, Blackwell.
 GIDDENS, A., 1990: The Consequences of Modernity. Polity and Stanford University Press, Cambridge and Stanford.
 HALL, S., 1996: Introduction: Who Neds Identity? In: Hall, S. and du Gay, P.
 Hobsbawm, E. J. (1990) Nations and Nationalism since 1780: Programme, Myth, Reality, Cambridge, Cambridge University Press.
 Hobsbawm, E. J. (1990) Nations and Nationalism since 1780: Programme, Myth, Reality, Cambridge, Cambridge University Press. Habermas. Jürgen. Botimi shqip- "Ah Europe"
 Hantington.S.P.Përplasja e Qytetërimeve, botimi shqip logos. 2004
 Risse, Thomas (2001), 'A European Identity? Europeanisation and the Evolution of Nation-State Identities', in: Cowles, Maria Grën, James A. Caporaso, and Thomas Risse (eds.), Transforming Europe. Europeanisation and Domestic Change, Ithaca [u.a.]: Cornell University Press, pp. 198-216.
 Risse, Thomas (2004), 'European Institutions and Identity Change: What Have We Learned?', in: Herrmann, Richard, Marilynn Brewer, and Thomas Risse (eds.) (2004), Transnational Identities: Becoming European in the EU, Lanham, Md. [u.a.]: Rowman & Littlefield.
 SMITH, A. D., 1991: National Identity. London, Penguin.
 SMITH, A. D., 1995: Nations and Nationalism in A Global Era. Cambridge, Polity Press.
 Athony D Smith, Identity National and idea of European Unity
 Şçlenker-Fişçer, Andrea (forthcoming), Multiple identities in Europe: a conceptual and empirical analysis, in: Fuçs, Dieter and Hans-Dieter Klingemann: European identity, Cultural diversity, and Legitimacy, Edgar Elgar.
 Valery. P "La crise de l'esprit"
 Plasari. A. (2005). Rrembimi I Europës.
 Plasari. A. (2005). Europa nga Rrenjet
 Plasari. A. Vija e teodosit Rishfaqet, nga Duhet t'ja Mbajne Shqiptaret?
 Kadare. I. Identiteti europian I shqiptareve
 Kadare, I. Ardhja e Migjenit ne Letersine shqipe
 Frashëri.K. Të metat e debatit Qose- Kadare
 Frashëri. N. "Histori e Skenderbeut".
 Qose. R "Realiteti I Shperfillur" polemika me I. Kadarenë botuar në 2006
 Frashëri . S "Shqipëria ç'ka qënë, ç'është, e ç' do të bëhet.
 Sulstarova. E. Arratisje nga Lindja

EVOLUIMI I KULTURËS POLITIKE NË BALLKANIN PERËNDIMOR PAS PERIUDHËS KOMUNISTE: RASTET E SHQIPËRISË DHE FYROM

ILIR KALEMAJ PH.D
University of New York Tirana

ABSTRAKT

Punimi ka për qëllim studimin dhe analizimin e kulturës politike në vendet e Europës Lindore, konkretisht, në Shqipëri dhe Maqedoni, në periudhën paskomuniste. Gjithashtu synon të tregojë (mos)suksesin e përfaqësimit politik në këto dy vende, të eksplorojë arsyet që qëndrojnë pas kësaj dhe hapat që duhen ndjekur në lidhje me përmirësimin dhe reformimin e kulturës politike. Pyetja qendrore që shtron studimi është: si ka evoluar kultura politike në Shqipëri dhe Maqedoni? Ndërsa pyetje dytësore të cilat rreket të hedhë dritë janë inter alia kush ndikon në përfaqësimin politik? Sa e ka penguar trashëgimia komuniste nivelin e përfaqësimit në këto vende? Pse këto dy vende me karakteristika të ndryshme kanë ngjashmëri përsa i përket stadi të kulturës politike?

Argumenti bazë është që kultura politike në të dy vendet ka vuajtur si rezultat i faktorëve të ndryshëm, si tradita politike, trajektorja e ndryshme e tranzicionit dhe konteksti i ndryshëm socio-kulturor, por me rezultante të njëjtë. Me një fjalë dhe duke përdorur Metodën e Dakordësisë së Millit, këtu ndërmerren dy raste vendesh të ndryshëm por me një variabël të varur të përbashkët: mungesa e maturimit të kulturës politike në periudhën pas-komuniste.

Përsa i përket metodologjisë, së pari është identifikuar niveli i dobët i kulturës politike në Shqipëri dhe Maqedoni duke e shpjeguar me disa nga faktorët kryesorë që kanë ndikuar dhe e pengojnë një çështje të tillë të përmirësohet. Së dyti, metodologjia e përdorur është kryesisht induktive nga realiteti tek teoria duke e shpjeguar fenomenin nga realiteti tek teoria për të rishikuar në mënyrë kritike teoritë ekzistuese dhe studiuar shkaqet pse kemi devijime të rasti i Shqipërisë dhe Maqedonisë, përsa i përket nivelit të kulturës politike. Këtu kam përdorur vençanërisht analizë ligjërimi dhe përmbajtje, si dhe nëpërmjet vëzhgimit dhe studimit të proceseve (process-tracing) në periudha të caktuara të shoh nivelin e përfaqësimit dhe perceptimit të kulturës politike në të dy vendet.

Hyrje

Kultura politike është një koncept që lidhet kryesisht me proceset politike, por i sheh si të ndërlidhura dhe studion ndërveprimin me ato sociale, kulturore dhe ekonomike. Një nga çështjet kryesore flet për përfaqësimin politik ose më saktë për mënyrën se si qytetarët përfaqësohen me ose pa informacionin e duhur politik, gjë që ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve të politikës. Përderisa politika është forma e jashtme dhe strukturore e ndërtimit të një shteti a kombi, kultura është esenca e brendshme që i jep frymë e identitet. Në këtë linjë ka përcaktime të ndryshme rreth konceptit “kulturë politike” por do citoj një përkufizim sipas Almond dhe Verba: “si tërësia e vlerave, normave, njohurive, qëndrimeve dhe ndjenjave që përcaktojnë sjelljen politike ndaj sistemit politik” (Almond & Verba 1963). Me fjalë të tjera, ata e konsideronin kulturën politike si një elementë që lidh sjelljet individuale me sistemin politik në tërësi. Sikundër shprehet një studiues shqiptar: “një politikë e avancuar dhe në funksion të interesave të përbashkëta, sigurisht që sendërtohet mbi baza të fuqishme kulturore i cili krijon elita të fuqishme” (Ukaj 2010:5). Ndërsa në rrafshin empirik do thoja, ajo shpie drejt një konstatimi të qëndrueshëm se vetëm ato shoqëri që kanë kaluar nëpër fazat e mirëfillta të zhvillimeve kulturore, mund të jenë shoqëri të mirëqenies. Si shembull mjafton t’u referohemi shoqërive që i quajmë perëndimore, të cilat në esencë, politikën e kanë kulturë, ndërkaq kulturën pjesë funksionale të politikës. Kultura dhe politika janë dy fushat themelore të një shteti, ku përjashtimi i kulturës nga politika dhe anasjelltas, është shumë i rrezikshëm për shëndetin e një kombi. Për të funksionuar mirë një shtet, lypset që këto dy komponentë të ketë të zhvilluar paralelisht, të cilat duhet ta stimulojnë njëra-tjetrën dhe jo asses ta luftojnë njëra-tjetrën.

Një demokraci ka nevojë për një kulturë të mirëfilltë politike në mënyrë që të funksionojë si shteti ashtu dhe masa në tërësi. Ky studim është fokusuar drejt përvetësimit dhe mënyrës se si kultura politike ka evoluar në Shqipëri dhe Maqedoni pas periudhës komuniste e deri më sot, duke dhënë një panoramë të përgjithshme për të dyja vendet. Një çështje që përbën interes është edhe kultura kontradiktore për vendet që braktisën komunizmin pra, në konflikt me “kë” dhe për “çfarë”. Në vijim të kësaj kam shtruar dhe çështjen e pjesëmarrjes nga vitet 1990-2012 duke nxjerrë në pah dallimet dhe të përbashkëtat ndërmjet tyre nëse ka dhe faktorët që ndikojnë nëse ka pjesëmarrje të ulët apo të lartë. Pas kësaj një çështje që lidhet drejtpërsëdrejti me çështjen paraardhëse është nëse pjesëmarrja sjell avantazhe apo disavantazhe për demokracinë dhe normalisht parë nëpërmjet studiuesve të ndryshëm. Po ashtu jam munduar të analizoj edhe disa nga drejtimet ku mund të reformohet kultura politike. Dhe në fund përfundimi se nuk kemi kulturë politike dhe për këtë arsye na mbetet që të ndërgjegjësohemi si shoqëri pikësepari, dhe më pas të kërkojmë një frymë kontribuimi me instancat e larta për të krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë midis të zgjedhurve dhe zgjedhësve.

Kultura politike në periudhën post-komuniste në Shqipëri dhe Maqedoni

Për të shpjeguar më mirë ecurinë e proceseve transformuese në vendet e Evropës Juglindore, si dhe modelet e zhvillimit të sistemeve zgjedhore, atyre partiake dhe qeverisëse, për mendimin tim është e nevojshme të merret në analizë niveli i kulturës politike dhe i trashëgimisë së të kaluarës. Këto dy elemente kanë pasur ndikim kryesor në formatimin e sistemeve të reja politike, në sjelljen elektorale e politike, si dhe në aftësinë e shoqërive paskomuniste për të ndërtuar modele të hapura të shoqërive të lira e demokratike. Kultura politike sipas historianit Hanisch (1970) është një “përzjerje e orientimeve, qëndrimeve dhe marrëdhënieve në proceset dhe strukturat politike”. Ajo shpreh pikëpamje politike që kanë për botën qytetarët, grupet e mëdha sociale dhe elitat funksionale. Studiues si Sartori (1987) apo Offe (1991) e vlerësojnë kulturën politike si tregues të nivelit të demokracisë dhe të aftësisë së një shoqërie për t’iu përshtatur parimeve dhe vlerave të sistemit të ri. Studiuesja polake Ana Volk-Poveska në studimin mbi demokracinë dhe ekonominë e tregut në Evropën Lindore shkruan se “kultura politike e shoqërive që braktisën komunizmin është e mbushur plot me paradokse, të cilat lidhen me karakterin edhe thelbin e proceseve të periudhës transitore. Ato mund të gjenden në konfliktin midis sistemit politik dhe interesave të shoqërisë, në konfliktin midis qëllimeve dhe mjeteve, në konfliktin e besueshmërisë integruese” (Vajdenfeld 1999: 43). Për pasojë, lindja e një kulture politike që përmban “norma të vjetra dhe përvoja të reja, mund të krahasohet me kalimin nëpër një shteg të panjohur, ku është i nevojshëm kualifikimi i vazhdueshëm”. Poveska paralajmëron për shfaqjen në këtë proces të gabimeve të cilat as nuk mund të parashikoheshin dhe as mund të mënjanoheshin më parë. Në vazhden e kësaj logjike arsyetimi, në një studim profesional mbi trashëgiminë komuniste, studiuesi Wojtek Lamentoicz rendit “tetë paradokset e kësaj trashëgimie me ndikim në kulturën politike dhe ecurinë e periudhës transitore” (Lamentoicz 1999: 63).¹

Këtu me rëndësi për tu shtjelluar nga këto paradokse është pikërisht paradoksi i nihilizmit të dyfishtë, i shoqërisë së konsumuar emocionalisht dhe paradoksi i mosbesimit. Pra, paradoksi i “nihilizmit të dyfishtë”, që do të thotë sa më e suksesshme të jetë elita në pushtet në nxitjen e qëndrimeve relativiste dhe/ose nihiliste përkundrejt normave dhe vlerave të trashëguara (psh morali “reaksonar” dhe “jashtë mode” feja, traditat juridike), aq më pak sukses do të ketë ajo, përgjithësisht në futjen e

← Ato janë paradoksi i nihilizmit të dyfishtë (nihilizmi ndaj gjithçkaje të kaluar, mund të kthehej de fakto në nihilizëm edhe ndaj vlerave të reja të demokracisë), paradoksi i instrumentalizimit të dyfishtë (përdorimi i normave juridike si instrument i të drejtës, si kundërvënie në përdorimin e saj si instrument kontrolli për shndërrimet shoqërore), paradoksi i ideologjisë utopike (projektet utopike ideologjike, si pengesë e ideologjive realiste e pragmatiste), paradoksi i mungesës së rendit të fortë kushtetues (rregullat e ashpra e të ngurta mund të jenë pengesë dhe burim informaliteti), paradoksi i anarkisë burokratike (sasi e madhe vendimesh, pamundësi zbatimi të tyre), paradoksi i marrjes së vendimeve (sa më shumë vendime të pakufizuara, aq më pak zbatohen e kanë jetëgjatësi ato), paradoksi i një shoqërie të konsumuar emocionalisht (mobilizim ekstrem nga lart sjell zhgënjim e apati), si dhe paradoksi i mosbesimit (kalimi i besimit nga institucionet tek liderët karizmatikë).

normave dhe vlerave, që ajo i sheh si më progresive dhe më të përshtatshme (Vajdenfeld 1999: 66). Nihilizmi kundër vlerave të hedhura poshtë, i cili duhet të përgatisë rrugën për në modernizëm, kthehet në nihilizëm kundër normave, parimeve dhe vlerave të dëshiruara. Sa më rigorozisht të shkatërrohen rregullat e vjetra, aq më të paaftë bëhen njerëzit për të vendosur dhe për të zbatuar të reja. Po ashtu paradoksi i një “*shoqërie të konsumuar emocionalisht*”: sa më tepër një shoqëri të jetë e mobilizuar nga liderët, për të besuar në premtimet zyrtare, aq më pak qytetarët e kësaj shoqërie do të jenë në gjendje të angazhohen emocionalisht për çështje të caktuara publike. Në qoftë se mobilizimi politik nga lart, si pasojë e iluzioneve që ka ngjallur, ai shkakton vetëm zhgënjim, ai pasohet, thuajse, përherë nga cinizmi, largimi nga skena publike, ndryshimi i preferencave në zgjedhje dhe kërkimi të vazhdueshëm i sigurisë, në mes të pasigurisë mbisunduese. Një shoqëri e konsumuar emocionalisht nuk është më e gatshme të përkrahë ndonjë çështje politike dhe ndodhemi përballë “paradoksit të *mosbesimit*”, [ku] besimi i mangët tek institucionet publike mund të zëvendësohet me besimin te figura të fuqishme udhëheqëse e karizmatike” (Vajdenfeld 1999: 67). Ky besim në persona nuk mund, natyrisht, të mbajë gjatë, meqenëse kultura e zëvendësimit nuk ka rrënjë të thella dhe është heterogjene. Lindja e mosbesimit riprodhon deficitet besueshmërie ndërmjet elitës në pushtet dhe qytetarëve, çka mund të çojë në kriza legjitimiteti të shpeshta.

Ekzistojnë disa teori që bëjnë klasifikimin e vendeve ish-komuniste dhe dallimin e tyre në pjesën qendrore dhe juglindore. Njëra prej tyre bazuar në faktorin strukturor, duke iu referuar vendeve ish-sovjetike, e lidh atë me trashëgiminë, historinë dhe kulturën e këtyre vendeve. Vendet postkomuniste me shpërndarje më të madhe të pushtetit politik dhe të aktorëve me veto në procesin e vendimmarrjes politike kanë arritur të krijojnë më shpejt një sistem të stabilizuar dhe efektiv, sesa vendet në të cilat pushteti politik është më i përqendruar. Huntington e shpjegon konfliktin politik në botë me “përplasjen e qytetërimeve, duke paralajmëruar se vendet lindore, të cilat janë më të lidhura me perëndimin në fushën e historisë dhe të fesë do të kenë më shumë sukses në vendosjen dhe zhvillimin e regjimeve demokratike” (Huntington 2011: 325). Studiuues të tjerë e lidhin atë me aspektin gjeografik, sipas të cilit vendet që ndodhen gjeografikisht më afër perëndimit të zhvilluar do të shënojnë hapa më të shpejtë drejt demokratizimit. Teoritë e dyta nuk bazohen në strukturën e vendeve, por në aktorët politikë. Mbështetësit e kësaj teze mendojnë se, sistemet dhe faktorët strukturorë të padukshëm nuk mund ta bëjnë vendin as demokraci dhe as diktaturë. Njerëzit mund ta bëjnë. Por disidenti rumun, Gashpar Tomashia dedikon ndryshimin më shumë reagimit të një mase liberale sesa individëve të veçantë. Ai thotë se rënia e regjimeve komuniste nuk erdhi nga disidenca, edhe pse ai faktor pati një ndikim në këtë proces; dhe se, me përjashtim të Polonisë, disidentët kanë luajtur një rol krejt të papërfillshëm në politikë. Për Tomash, “disidentët bënin një jetë ku kënaqësitë, arritjet, disfatat dhe ndjenja e dështimit ndryshonin shumë nga ato që përjetonte popullsia në përgjithësi. Wolfgang Merkel është më konkret kur bën një klasifikim të nivelit të kulturës politike në vendet ish-komuniste” (Tomash 1998: 13). Në studimet e tij, vendet ndahen në tri grupe të mëdha: vendet me nivel të lartë të kulturës politike (Slloveni, Estoni, Çeki, Hungari, Kroaci, Sllovaki, Poloni e Lituani), vende ku kultura qytetare ndodhet ende në proces konsolidimi (Bullgari, Rumani, Letoni, etj), si dhe kategoria e tretë me standarde të ulëta të demokracisë dhe elitave politike. Në këtë të fundit bëjnë pjesë dy nënndarje, (Serbia, Shqipëria, Maqedonia), si dhe nënndarja e fundit me Rusi, Moldavi e Bosnje. Edhe në klasifikimin që Merkel në të njëjtin punim i bën nivelit të konsolidimit të sistemeve elektorale dhe sistemeve të përfaqësimit politik kemi të njëjtën renditje, e para Sllovenia dhe e fundit nga 19 vendet ish-komuniste, Bjellorusia. Në klasifikimin për cilësinë demokratike të sistemeve politike në Evropën Lindore, Sllovenia kryeson me 9.55%, në grupin e parë të demokracisë kushtetuese, ku bëjnë pjesë edhe Kroacia, Rumania dhe Bullgaria. Në grupin e dytë të “demokracisë difektoze” bëjnë pjesë Serbia, Maqedonia, Shqipëria dhe Bosnja. Pra, argumenti i tij mbi “kulturën politike” përputhet me argumentin mbi “progresin e demokracisë” në vendet paskomuniste. Autorë të tjerë me fokus analizën e periudhës transitore në vendet e Evropës Lindore, diferencat kulturore shpesh i bazojnë edhe në ndarjet midis vendeve katolike, vendeve ortodokse dhe atyre me popullsi myslimane. Kjo theksohet sidomos kur “kultura politike” si fenomen kulturor dhe politik në Evropën Juglindore shoqërohet në krahasime studimore me modelet perëndimore.

Dallimet gjenden në traditën historike (një perëndim i krishterë katolik dhe një lindje kryesisht ortodokse), e cila ka pasur ndikimet e veta në krijimin e perceptimeve të ndryshme qytetare mbi jetën, shoqërinë, komunitetin, solidaritetin njerëzor, parimeve morale, raportet e besimit dhe lirisë, shkëmbimet dhe ndikimet e jashtme. Huntington thotë se nuk kemi të bëjmë me dy modele diametralisht të kundërta, por të ndryshme, pra me dallime (Huntington 2011: 197). Trashëgimia bizantine në lindje krijoi raporte të forta ndërvarësie midis elitave politike e institucionale, si dhe institucioneve fetare, kurse në perëndim dominoi ideja e bashkëjetesës midis institucioneve fetare dhe shtetit laik. Modelet perëndimore i krijuan nocionet e ndarjes së pushteteve shumë më herët sesa në modelet lindore, në të cilat struktura hierarkike dominoi mbi çdo model tjetër të organizimit politik e shtetëror. Modelet shtetërore ishin shumë të centralizuara, dhe në kushtet kur edhe kisha kishte varësi të plotë nga shteti, nuk kishte pronarë tokash të pavarur nga shteti. Martin Mendelski në studimin e tij mbi reformat institucionale në vendet e EJT bazohet ndjeshëm në tezën e dallimeve që burojnë për shkak të trashëgimisë hasburgase përkundër trashëgimisë osmane (Mendelski 2007). Sipas tij, indikatorët e qeverisjes në EJT në këto dy periudha nxjerrin në hap qartazi dallimin e thellë midis p.sh, Sllovenisë-austro-hungarezë dhe Maqedonisë e Shqipërisë osmane, dhe se në këto vendet e fundit zhvillimi ekonomik ishte shumë më i ulët. Ai bën përgjegjës modelin strukturor, të dy modeleve, gjë që del në pah edhe në periudhën midis dy luftërave. Sipas tij Shqipëria dhe Maqedonia patën tregues më të ulët se Sllovenia, Kroacia etj. (Mendelski 2007). Historikisht është e qartë se, pothuajse të gjitha vendet e Evropës Juglindore patën një trashëgimi të gjatë të periudhës osmane (Tomash 1998: 198). Përplasja midis trashëgimisë osmane, trashëgimisë me ndikim perëndimor, si dhe identiteteve të tyre etnike e kombëtare luajti një rol me rëndësi në procesin e krijimit të një identiteti politik, mënyre të menuari dhe reagimi në mjedisin e brendshëm politik apo në raport me të tjerët. Rënia e modelit kulturor osman i detyroi shumicën e këtyre vendeve të përpiqen të krijojnë elitat e reja, të cilat, për shkak të pozitës shtypëse dhe të diferencuar të pjesës së krishterë të banorëve, do të duhej ta nisnin këtë proces nga e para. Ndarja dhe diferenca e tyre ishte e theksuar, ndryshe nga modelet e vendeve të tjera,

si p.sh, modeli shqiptar, etj, ku midis elitave otomane dhe atyre kombëtare kishte njëfarë lidhje dhe elementë trashëgimie apo vazhdimësie. Në thelb, megjithëse përpjekjet e vendeve të Evropës Juglindore për një ndarje të plotë nga modelet kulturore osmane, trashëgimia otomane ishte shumë më e fuqishme dhe më me ndikim në aspektet e tjera shoqërore, si në marrëdhëniet ekonomike, jetën sociale dhe jetën e përditshme. “Në një prej studimeve analizuuese të periudhës transitore në vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore theksohet se, dilemat e kësaj periudhe mbështeteshin në disa faktorë kryesorë” (Hyskaj 2008: 29) të tilla si trashëgimia e periudhës së perandorive të mëdha, përzgjedhja e politikës, distanca nga komunizmi, distanca nga trashëgimia perandorake, ndikimi i mjedisit ndërkombëtar, si dhe trashëgimia politike e komunizmit.

Teza të tilla mbrojnë, në mënyrën e tyre, shumica e studiuesve të njëjtit proces historik. Diferencat mund të gjenden vetëm në argumentet dhe prioritetet e klasifikimit. Për disa vende kanë rol kryesor proceset e hershme politike e historike, për disa të tjera trashëgimia e periudhës komuniste. Ato që ne sot i përfaqësojmë si ideale, janë ideale që u arritën gjatë rrjedhës së një procesi të gjatë maturues në Evropën Perëndimore”. Në Shqipëri dhe Maqedoni, trashëgimia komuniste përbën një element tjetër më rëndësi në formimin e kulturës politike. Ajo ka qenë një nga pengesat kryesore për ndalimin e përpjekjeve për demokratizim. Ajo ishte e vetmja trashëgimi përafërsisht e njëjtë, për shkak se, tiparet dhe mënyra e funksionimit të shtetit, shoqërisë, jetës qytetare dhe mendimit politik ishte thujse unike në çdo vend. Duke analizuar rastin shqiptar, mendoj se procesi i vendosjes së demokracisë ndeshet me sfida të jashtëzakonshme, të cilat e bënin demokratizimin e vërtetë të dukej pothuajse i pamundur dhe kjo lidhet me faktin se “për afro gjysmë shekulli Shqipëria kishte qenë e izoluar nga bota e jashtme dhe nga vlerat dhe parimet demokratike. Ky izolim, bashkë me mungesën e traditave demokratike, kishte ngulitur dhe rrënjësuar vlera dhe qëndrime që nuk ishin shumë të favorshme për zhvillimin e demokracisë”. Aspektet e tjera të kulturës politike, siç janë respekti për Tjetrin dhe votën kundër, dialogu konstant e produktiv politik, bashkëpunimi politik parlamentar pavarësisht raporteve të përfaqësimit, nevoja për institucione të forta në vend të liderëve të fortë politikë, pjesëmarrja e lartë në zgjedhje apo zgjerimi i rrethit të vendimmarrjes politike, -janë dukuri ende të brishta në të gjitha vendet e Evropës Juglindore. E ndodhur në pjesën juglindore të Evropës, e shkëputur kulturalisht dhe politikisht në periudha të ndryshme historike prej saj, rajoni i Evropës Juglindore vuan edhe nga ajo që shpesh quhet “moskuptim” dhe “mosnjohje” midis saj dhe pjesës perëndimore të kontinentit.

Kultura kontradiktore në shoqëritë postkomuniste: Rastet e Shqipërisë dhe FYROM

Kultura e re politike e shoqërive postkomuniste është një produkt procesesh, që po zhvillohen, të paktën në tre dimensione:

– në dimensionin universal, ku kultura politike shoqërohet me simptomat dhe dukuritë tipike për çdo kthesë që shoqërohet me ndryshim sistemesh/ regjimesh politike dhe jo thjesht rotacion politik normal; (2) në dimensionin rajonal, ku element i saj integral janë ndryshimet strukturore, karakteristikë për ato vende të cilat gjenden në rrugën nga komunizmi për në rendin demokratik e të ekonomisë së tregut; (3) në dimensionin e “rrugës së veçantë”, ku historia, kushtet gjeopolitike dhe struktura kombëtare e shteteve posttotalitare ndikojnë në atë, që sfidat, para të cilave këto shtete gjenden, të kenë një karakter të diferencuar dhe një rreze veprimi të ndryshme.

Vendet në analizë, pra Shqipëria dhe Maqedonia bëjnë pjesë në dimensionin rajonal, të cilat sikundër shprehet Vajdenfeld (1999: 43) gjenden në rrugën nga komunizmi për në rendin demokratik. Kultura politike e shoqërive që braktisën komunizmin sipas studiueses polake Ana Volk-Poveska karakterizohet nga kontradikta të shumta. Para së gjithash mund të përmenden “[k]onflikti ndërmjet sistemit politik dhe interesave të shoqërisë: Si pasojë e proceseve të transformimit, vetë shoqëritë shqiptare dhe maqedonase kanë sjellë në pushtet forca politike të cilat po realizojnë një program reformash krejt në kundërshtim me dëshirat dhe interesat e shumicës” (Vajdenfeld 1999: 47). Në kundërshtim me objektivat social të revolucionit, si barazia, mirëqenia dhe drejtësia, demokracitë e reja po shkojnë drejt pabarazisë dhe përçarjes së shoqërisë. Qeveritë e shteteve postkomuniste janë të detyruara, sipas ligjeve dhe parimeve të ekonomisë së tregut dhe demokracisë, të ndërtojnë një shoqëri qytetare me interesa sociale të diferencuara në emër të një modeli, për shumicën e njerëzve teorikë dhe abstrakt. Qytetari i nivelit të mesëm, i cili përpigjet për përmbushjen e nevojave të tija kryesore, për çka dhe luftoi kur mohoi komunizmin, për një kohë të gjatë nuk do të jetë në gjendje të shohë interesat sociale të diferencuara si një atribut i një demokracie në konsolidim, çka është e barsvlershme edhe me besnikërinë e treguar ndaj sistemit të ri. Konflikti ndërmjet shtetit dhe demokracisë paraqitet si një dialektikë natyrore dhe jo si anormalitet. Ai del nga mungesa e konsensusit në lidhje me shkallën e pjesëmarrjes së shtetit në procesin e “ç’shtetëzimit” të shoqërisë dhe të privatizimit të ekonomisë. Nga njëra anë fundi i komunizmit identifikohet me kapitullimin e shtetit, i cili shihet si një i falimentuar që del përballë shoqërisë duarbosh por që mbetet, ende punëdhënësi më i madh, nga ana tjetër shteti vlen për të njëjtin qytetar si garanci e sigurisë shoqërore.

Nga ana tjetër kemi domosdoshmërinë e ç’montimit të njëkohshëm të rendit të vjetër dhe ndërtimit të një tjetri, të ri, shkakton një thellimin e distancës ndërmjet institucioneve të një shteti demokratik dhe përmbytjes së tij. Si pasojë Shqipëria dhe Maqedonia e shohin veten në situatë të atilla ku mungon kultura politike dhe normat e një shteti ligjor; ku ka pluralizëm politik pa aftësinë e bashkëpunimit ndërmjet grupimeve politike, parti popullore pa popull, parti kristiane pa të krishterë, ku sundon demokracia pa kulturë demokratike.

Së treti, kemi konfliktin e besnikërisë, ku vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, në kundërshtim me ata të Europës Perëndimore, janë të detyruar që t’i kryejnë njëkohësisht proceset e evropianizimit dhe të rajonalizimit. Formimi i një ndërgjegje evropiane, në kushtet e një identiteti kombëtar akoma të pa strukturuar, shkakton lindjen e nacionalizmit dhe prirjeve antidemokratike, duke u bërë pengesë në gjetjen e një ekuilibri ndërmjet lojalitetit të qytetarëve ndaj rajonit, shtetit

dhe Europës. Nga ana tjetër vinte në dukje Gëteja që në vitin 1827: “Demokracia nuk vrapon, por ecën me hap të matur”. Nevoja për të patur me çdo kusht një opozitë të demokratizuar ka krijuar një situatë, ku parti me programe pothuajse identike nuk marrin guximin të bashkëpunojnë me njëra tjetrën. Mungesa e kompromisit, kaq e nevojshme në luftën kundër diktaturës komuniste, në kushte normale nuk të sjell asgjë pozitive. Sepse, megjithëse pluralizmi politik bazohet në interesa shoqërore të ndryshme, rrezja e veprimit dhe sasia e problemeve, të cilat kanë nevojë për zgjidhje të shpejtë, kërkon një konsensus të gjerë të grupimeve politike lidhur me objektivat kryesore të tranzicionit dhe mjetet e rrugët për arritjen e tyre.

Një shoqëri qytetare është emëruesi i përbashkët i demokracisë dhe i ekonomisë së tregut. Ajo është hapësira e ndërmjetme mes individit dhe shtetit, ndërmjetësimi, i cili mundëson secilit të koeprojë me shtetin me vullnet të lirë e duke u renditur së bashku me të tjerët dhe njëkohësisht të ruajë pavarësinë vetjake përballë strukturave politike. Në këtë mënyrë, bëhet e mundur, që interesat dhe pikëpamjet individuale të integrohen në rrjetin e përgjithshëm të ndërveprimit njerëzorë. Përvoja perëndimore ka treguar se institucionet demokratike, bindjet liberale dhe një ekonomi tregu mund të konsolidohen vetëm atje, ku një shoqëri e tillë qytetare ka shekuj që ekziston. Gjithashtu individët duhet të kenë jo vetëm kulturë, të jenë të arsimuar, të respektojnë ligjet e një shoqërie demokratike, por më shumë se çdo gjë tjetër duhet të kenë edhe karakterin human e demokratik, si dhe të jenë të informuar për proceset vendim-marrëse, të kërkojnë transparence etj.

Pjesëmarrja politike në zgjedhje, krahasime dhe tipare dalluese

Pjesëmarrja në zgjedhje është një tregues i nivelit të interesit dhe pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrjen politike, i ofertave konkurruese të partive dhe besimit qytetar tek aktorët politikë. Në periudhën komuniste, në vendet ish -komuniste, pjesëmarrja në zgjedhje e qytetarëve me të drejtë vote ishte e detyrueshme. Sikundër shprehet një politolog vendas, “[n]ë disa vende si Shqipëria, Gjermania Lindore, Çekosllovakia apo Rumania pjesëmarrja ishte 99-100%, por në vende si Jugosllavia, kushtëzimi i votimit ishte më liberal, ndaj edhe atje, midis viteve 1974-1986 pjesëmarrja ishte midis 86%-93% të zgjedhësve” (Krasniqi 2012: 41). Në demokraci, koncepti i pjesëmarrjes është vullnetar dhe varet nga ndërgjegjia qytetare. Një pjesëmarrje e gjerë, kur është fjala në një sistem konkurrues e rrit ndjeshëm edhe përgjegjësinë e aktorëve politikë ndaj kërkesave dhe shqetësimeve qytetare. Gjithashtu, pjesëmarrja e gjerë është një pjesëmarrje më shumë cilësore sesa sasiore. Pjesëmarrja e ulët në votime lë të kuptohet se kanë votuar kryesisht anëtarësia militante e partive politike; çdo pjesëmarrje e lartë lë të kuptohet se kanë votuar edhe pjesa e pavendosur dhe, sidomos, pjesa që është në përgjithësi skeptike ndaj zhvillimeve politike dhe proceseve elektorale. Referuar studimeve mbi pjesëmarrjen politike në proceset zgjedhore shqiptare, rezultoi se, dy partitë e mëdha arrijnë të mobilizojnë, edhe në rastin më të keq, rreth 35% të elektoratit, i cili përbën pjesën militante të këtyre partive. “E njëjta analizë dëshmon se, rreth 20-25% e elektoratit refuzojnë të jenë pjesë e proceseve zgjedhore sepse janë tërësisht indiferentë ndaj politikës ose të zhgënjyer prej saj. Pjesa e mesme prej 20-25% e zgjedhësve është pjesa që vendos fatet e fituesve të zgjedhjeve” (Krasniqi 2012: 43).

Gjithashtu, praktika shqiptare dëshmon se dy partitë e mëdha kanë fituar të paktën 40-45% të votave kombëtare, ose 20-30% më shumë sesa pjesa militante e tyre në raport me numrin total të votuesve. Përcaktues bëhen të pavendosurit, në zgjedhjen e tyre racionale mbi ofertën politike dhe vendimi i tyre merret zakonisht në momentet e fundit të fushatës dhe të votimit. Në kategorinë e abstenuesve, në zgjedhje bëjnë pjesë dy grupime të ndryshme, të cilët studiuesi Jean Blondel i ndan në “abstenues negativë” dhe “abstenues pozitiv”. Në grupin e parë bëjnë pjesë ata që nuk janë të interesuar për politikë, dhe ngjarjet politike, përfshirë zgjedhjet. Kurse, grupimi negativ janë të tillë sepse nuk kanë preferencë për kandidatët ose ofertat politike të partive. Studimet tregojnë gjithashtu se, sa më e lartë të jetë pjesëmarrja e saj në zgjedhje, aq më të mëdha janë shanset për një ndryshim në drejtimin politik të vendit. Sa më e ulët të jetë pjesëmarrja e kësaj pjese në zgjedhje, aq më të larta janë shanset e partisë në pushtet për të vijuar një mandat tjetër qeverisës. Në një rrafsh më të gjerë krahasues vijnë në ndihmë teoritë e mobilizimit, të cilat bazohen në rolin e agjentëve mobilizues, si burim i pjesëmarrjes zgjedhore qytetare. Argumenti kryesor është se, qytetarët kërkojnë një katalizator, një faktor nxitës që t’i shtyjë ata të marrin pjesë në votime. Ky katalizator mund të jetë një kandidat, një parti politike, një lloj tjetër organizate ose rrjeti social, etj, i aftë të bindë zgjedhësit të jenë aktivë dhe pjesëmarrjes në votime.

Mund të ndodhë që, midis individëve me të njëjtat tipare social-ekonomike, të ketë shkallë të ndryshme të pjesëmarrjes në zgjedhje, për shkak të agjentëve mobilizues dhe rrethanave specifike. Rrethana specifike në modelet e zgjedhjeve në Evropën Lindore e Juglindore janë p.sh, nëse zgjedhjet lidhen me ndryshimin e sistemit politik (1990-1991), nëse zgjedhjet lidhen me nevojën e një zgjidhje të re politike, pra rotacionit të domosdoshëm politik, nëse zgjedhjet bazohen në debatet programore apo në garën midis individëve –lider kandidatë për Kryeministër, nëse zgjedhjet zhvillohen mbi bazë kombëtare apo etnike, nëse zgjedhjet mbahen me sistem mazhoritar apo me sistem proporcional dhe, në rastin e këtyre të fundit, nëse listat elektorale janë të mbyllura apo ofrojnë shanse zgjedhjeje nominale edhe për votuesit. “Studimet elektorale dëshmojnë se, konkurrenca e fortë mazhoritare shoqërohet gjithnjë me pjesëmarrje më të lartë në votime, pasi çdo kandidat, parti dhe staf elektorale lufton për çdo votë të vetme” (Krasniqi 2009: 58). Shanset për kandidatët e pavarur dhe jashtë partive kryesore, mbeten gjithnjë minimale. Në modelin shqiptar, vetëm një kandidat ka arritur të fitojë garën reale me partitë e mëdha në sistemin mazhoritar, kryetari i tanishëm i Kuvendit Meta, më 2005, në zonën e Skraparit. Në sistemin proporcional, sidomos në atë me lista të mbyllura, pjesëmarrja është më e ulët. Qytetarët nuk kanë ndonjë lidhje emocionale me kandidatët, ndaj ata më shumë votojnë imazhin, liderin dhe ekipin e tij drejtues, sesa kandidatët për deputetë. Në këtë rast, as kandidatët dhe as partia politike nuk luftojnë për çdo votë, por kalkulojnë zonat dhe votat, duke luftuar të kapin përqindjet që u mundësojnë përkthimin në mandate.

Në rastin e votimeve etnike, situata është tjetër. Studiuesit vlerësojnë se partitë etnike funksionojnë si parti nacionaliste, dhe si të tilla ato kanë avantazh konkurrues ndaj partive politike të masës së gjerë, për shkak se, këto parti nuk kanë luhatje të madhe të votave nga zgjedhja në zgjedhje, nuk ndëshkohet aq shumë nga sistemi zgjedhor, e drejton fushatën me një kosto më të ulët dhe natyrisht, në anëtarësinë e tyre ka më pak erozion sesa në partitë e tjera popullore. Për shembull, vlen të përmendet se “nga përvoja rajonale, zgjedhjet, në Maqedoni, në Malin e Zi, etj, janë ndikuar dukshëm nga votimet etnike dhe nxitja e partive etnike e nacionaliste për të mobilizuar votuesit etnikë për pjesëmarrje dhe votë mbështetëse” (Krasniqi 2009: 60). Kaq e dukshme është kjo ndarje, sa që në Maqedoni, partitë maqedonase e shqiptare veprojnë vetëm në zonat etnike, duke mos i kushtuar vëmendje elektorale as formale zonave të etnisë tjetër. Një faktor tjetër më rëndësi në nivelet e përfaqësimit është hapësira ligjore e ushtrimit të drejtës së votimit për emigrantët e rinj të Evropës Juglindore. Pra, në vendet si Maqedonia lejohet dhe mundësohet pjesëmarrja në votime edhe e qytetarëve të këtyre vendeve që jetojnë e punojnë në vende e kontinente të tjera në botë. Në rastin shqiptar, kjo nuk mundësohet, dhe kështu, automatikisht është e pritshme se një masë e madhe e votuesve madhorë janë paraprakisht mospjesëmarrës në zgjedhje dhe në procesin e vendimmarrjes së brendshme politike. Analiza e zgjedhjeve parlamentare në Evropën Lindore dallon shumë nga modelet e gatshme të analizës për zgjedhjet në vendet perëndimore, ku demokracia ka një përvojë të gjatë dhe elektorati është prej dekadash i shtresuar mbi bazën e statusit social, ideologjik, fetar dhe politik. Në vendet ish-komuniste, pluralizmi erdhi në kushtet kur nuk ekzistonin pronarët dhe as bota e biznesit, kur shumica e qytetarëve jetonin në zonat rurale dhe kur me ideologji politike nënkuptohej ndarja bardh e zi në komunistë dhe antikomunistë. Disa vende kërkuan 3-4 procese zgjedhore kohë për të filluar të veprojnë sipas modelit perëndimor, pra për të krijuar shtresimet elektorale dhe, bashkë me to, edhe mbështetësit e arsyeshëm elektorale. Ndërsa në Shqipëri dhe Maqedoni ky proces ende nuk ka përfunduar. Zgjedhjet e fundit politike në Bullgari, Rumani, Kroaci apo vende të tjera rajonale janë përcaktuar më shumë nga kërkesa e presioni pozitiv qytetar për të luftuar korrupsionin e qeverisë në pushtet, sesa për të identifikuar opozitën me një identitet të përcaktuar social e politik. Fakti se në Shqipëri, Hungari, Rumani, etj, zgjedhësit janë të gatshëm të rikthejnë në pushtet një lider politik të larguar më parë prej tyre me akuza për korrupsion dhe keqqeverisje, më shumë se identitetet sociale shpjegohet me votën e tyre kundër atyre që janë në qeveri, pra një zgjedhje pragmatiste, proteste dhe racionale, përmes të cilës ata nuk besojnë, por vetëm shpresojnë për më mirë. Shembull konkret është përvoja shqiptare, në të cilën provohet teza se, faktori lideri, faktori i njohjes personale e krahinore, si edhe faktori ideologjik janë shumë më ndikues sesa ai social. Për këtë arsye, në të gjitha zonat e pasura të vendit dominuese është e majta politike, kurse në zonat e varfra të periferisë, dominuese janë partitë e djathta politike.

Studimet e kryera tregojnë se zgjedhësit nuk nisen nga motive fetare për të zgjedhur një parti politike. Ndikimi më i madh zgjedhor është në Rumani me 28%, kurse në të gjitha vendet e tjera të rajonit, ndikimi është nën 20%, madje në vende si Shqipëria është 8%. Kur pyetën sa është e rëndësishme feja në jetën e tyre, shqiptarët kanë përqindjen më të ulët në rajonin e Evropës Juglindore, me 35-36%, kur në vende të tjera të rajonit, siç janë Maqedonia kjo përqindje shkon 75%. Rajoni i Evropës Juglindore paraqet deficite të theksuara edhe për sa i përket aplikimit të demokracisë së drejtpërdrejtë. Në këtë rajon janë zhvilluar kryesisht vetëm dy modele referendimesh: ato për shpalljen e shtetësisë dhe pavarësisë, si edhe ato për miratimin e dokumenteve kushtetuese. Referendimet për çështje konkrete të politikës janë minimale. Të dhënat e këtyre vendeve dëshmojnë se, në Maqedoni janë bërë dy referendime (pavarësia dhe marrëveshja e Ohrit), në Shqipëri tre referendime (dy për kushtetutën dhe një për formën e qeverisjes). Në tërësi, në vendet e rajonit, referendimet për tematikën e pavarësisë janë përdorur nga regjimet për interesa politike të ditës, jo për çështje madhore dhe afatgjatë. Duke iu referuar zgjedhjeve parlamentare nga viti 1990-2011 rezultoi se, vendi me përqindjen më të lartë të pjesëmarrjes politike është Sllovakia me 74%, ndjekur nga Sllovenia e Letonia me 72%. Në vendet ballkanike, Mali i Zi ka një përqindje të lartë prej 72% dhe Shqipëria 71%, por duke pasur parasysh se këto dy vende kanë kaluar përmes disa proceseve zgjedhore të kritikuar për mungesë të standardeve të demokracisë, atëherë dallimi i tyre me modelet e cituara më sipër duhet të jetë shumë më i madh sesa 0-1%. Tabela tregon se, pjesëmarrja politike në vende si Maqedonia, Bullgaria, Rumania e Bosnja është thuajse e njëjtë. Shqipëria dhe Kosova kanë rekordin e pjesëmarrjes në votime në zgjedhjet e para politike: në Shqipëri, më 1991 zyrtarisht morën pjesë 98,9% e zgjedhësve, 36% më shumë se në Poloni dhe 7-10% më shumë se në Bullgari, Rumani, Slloveni, etj. Rekordi shqiptar lidhet me një specifikë të veçantë: “në zgjedhjet e para nuk kishte mundësi dhe mekanizma monitorimi të saktësisë së zgjedhjeve dhe rritja fiktive e pjesëmarrjes ishte një nga kritikant kryesorë të raporteve ndërkombëtare për këto zgjedhje” (Krasniqi 2009: 63). Zgjedhjet e para politike u shoqëruan me një entuziazëm dhe interes të madh. Kjo gjen shprehje me pjesëmarrjen masive në zgjedhje. Në zgjedhjet e para shumë partiake pjesëmarrja ishte e lartë kurse në zgjedhjet e dyta pjesëmarrja ra dukshëm, me 2% në Maqedoni dhe 6-7% në Shqipëri. Në Bosnje kemi pjesëmarrje të njëjtë në tre zgjedhjet e fundit parlamentare, një tendencë e ecjes së njëtrajtshme që shfaqet edhe në Kosovë, në Serbi, në Shqipëri, etj. Në zgjedhjet e fundit politike, pjesëmarrja më e lartë vijon të jetë në Slloveni e Hungari, si edhe në Malin e Zi, por në këtë të fundit për rrethana specifike që lidhen me mbajtjen e zgjedhjeve menjëherë pas shkëputjes me referendum nga federata me Serbinë. Rumania e Shqipëria futen në listën e vendeve të Evropës Juglindore me përqindjen më të ulët të pjesëmarrjes në votime në zgjedhjet e fundit parlamentare, vend ku vetëm 40-50% e votuesve janë pjesëmarrës në zgjedhje. Në vendet e tjera përqindja është 5-7% më e lartë. Distancë gati të njëjtë midis zgjedhjeve të para dhe të fundit ka edhe Shqipëria me -48%, edhe këtu me tendencë rënie në çdo proces zgjedhor. Disa vende të tjera, si Serbia e Maqedonia në zgjedhjet e fundit, etj, kurba e pjesëmarrjes ndryshon: fillimisht ka një pjesëmarrje masive në zgjedhje, më pas një rënie drastike dhe më pas, një rikthim të tendencës për rritje të pjesëmarrjes.

Nisur nga përvoja e këtyre zgjedhjeve, ashtu siç shpjegohet edhe në teorinë e pjesëmarrjes zgjedhore, kurba e pjesëmarrjes shënon rritje kur elektorati i rikthehet besimi te procesi dhe shanset e votimit për ndryshim, kur ka oferta të reja serioze politike dhe kur pritet ose kërkohet rotacion pushteti. Nëse analizohen zgjedhjet e tjera politike (zgjedhjet parlamentare,

zgjedhjet lokale apo zgjedhjet evropiane), niveli i përfaqësimit të qytetarëve në zgjedhje ndryshon shumë. Një faktor ndikues në pjesëmarrje është modeli zgjedhor. Studimet profesionale dëshmojnë se, pjesëmarrja në zgjedhjet presidenciale kur Presidenti ka kompetenca të mëdha, është shumë herë më e madhe sesa në zgjedhjet parlamentare e lokale. E njëjta dukuri vërehet edhe në zgjedhjet vendore, në raportet e votimit në mazhoritar dhe ato në proporcional.

Kultura politike si element funksional për demokratizimin e shoqërisë shqiptare

Demokracia nuk mund t'i mëvetësohet kulturës politike. Demokracia e shëndoshë në Shqipëri varet shumë nga shkalla e zhvillimit të kulturës politike shqiptare, që do të thotë se çdo qytetar me sjelljet, qëndrimet, praktikat dhe normat morale të tij përcakton aftësinë si individ, si shoqëri dhe popull për tu vetëqeverisur. Shoqëria shqiptare, e ardhur nga një sistem politik totalitar komunist për pesë dekada, edhe me ardhjen e demokracisë në vitin 1990 trashëgoi një qytetari të diktuar dhe të nënshtruar, e cila në vetvete nxiste plogështi, rutinë dhe indiferentizëm." Prandaj është e domosdoshme që të bëhet një "kartarsis" i vërtetë filozofik në shoqërinë shqiptare, d.m.th. zhvendësimin në memorien bazë të individëve shqiptarë i përmbajtjes së vjetër të periudhës komuniste me një përmbajtje të re" (Kocani 2003: 2). Krejtësisht ndryshe, në realitetin e sotëm shqiptar kultura politike e një shoqërie të re demokratike është formuar nga veprimtaria e lirë e individit (individëve) dhe e komuniteteve (grupeve) të caktuara në këtë shoqëri" (Bardhi 2013: 4-18). Shtetasit e një shoqërie të lirë në demokraci ndjekin interesat e tyre, ushtrojnë të drejtat e tyre dhe përgjigjen për jetën e tyre private. Ata vendosin vetë për jetën e përditshme, për të tashmen dhe të ardhmen, për familjen dhe fëmijët e tyre, se ku do të jetojnë në Shqipëri, Europë, e në botë, se çfarë pune apo profesioni do të bëjnë sipas aftësive dhe bindjeve, se ku do të banojnë në qytet apo në fshat, a do të merren me politikë, art, filozofi, shkencë e kështu me një radhë të pafund interesash. Këto përbëjnë të drejtën e vetëvendosjes personale që ia ka dhënë atyre natyra dhe Zoti. Kultura politike, në kuptimin e gjerë të fjalës nuk ka të bëjë me konceptin, idenë, vizionin artistik, letrar, a muzikor, por me sjelljet dhe aftësitë e një populli në demokraci, me përgjegjësitë për të qeverisur ose për tu vetëqeverisur.

Ndihmesa më e madhe që demokracia duhet ti japë artit dhe artistëve është liria për të krijuar vepra artistike për njerëzit për të eksperimentuar, për të zbuluar botën e pafundme të shpirtit të njeriut, misteret e mendjes në gjithëkohësi, që do të thotë sa më shumë kulturë në shpirtin dhe në ndërgjegjen e çdo njeriu që aspirojnë për demokraci të vërtetë vlerash njerëzore. Në vijimësi të kulturës artistike, një pjesë përbërëse jetike e shoqërisë së sotme shqiptare demokratike është arsimiti i çdo shqiptari në mënyrë që të zhvillohet kultura demokratike bashkëkohore. Në kohën e qytetërimit të sotëm kërkohet shkalla e zhvillimit kulturor dhe arsimor sipas standardeve demokratike të vendeve të zhvilluara të Europës dhe botës moderne. Kërkesa e arsimit adekuat për ditët e sotme duhet të orientohen drejt formimit të qytetarëve me botëkuptim të lirë dhe të pavarur, kërkues e të aftë, me ide dhe vizione të qarta, koncepte dhe praktika të reja për demokracinë e dëshiruar nga çdo njeri në këtë jetë. Demokracia, sidomos në Shqipëri, ndryshe nga shoqëria autoritare, komuniste e djeshme e indoktrinuar, realizohet nëpërmjet arsimiti i cili përçon ngushtësisht interesat e caktuara personale, shoqërore, politike dhe kombëtare. Çdo njeri mund ti mësohet me të vërtetë parimi i demokracisë në kushtet e Shqipërisë në frymën e hulumtimeve të hapura, të cilat në vetvete paraqesin interesat demokratike për të gjithë shoqërinë. Sot te çdo shqiptar shpërthen energjia e konkurrencës dhe e debatit të gjallë, për të shpalosur idetë, mendimet, alternativat bashkëkohore në hapësirat e demokracisë shqiptare. Arsimiti, dituria, kultura në demokracinë e sotme shqiptare luajnë rol të veçantë në shoqërinë e lirë qytetare e sidomos në zonat e prapambetura, kur ende ekziston analfabetizmi, injoranca, varfëria ekonomike e çdo gjë tjetër." Po ashtu zhvillimin e kulturës politike e pengojnë një sërë faktorësh të tillë si: Mungesa e infrastrukturës së duhur kulturore, investimet si dhe nga mungesa e politikave ndërgjegjësuëse" (Veselaj 2002: 21). Në zgjedhjet e 28 qershorit të 2009 lindën konflikte dhe mosmarrëveshje për rezultatet e votimit, të cilat kërkojnë zgjidhje në interesat e së mirës së përgjithshme. Demokracia në vetvete nuk është gjë tjetër veçse një sërë rregullash për zgjidhjen e konfliktit me kulture demokratike. Në të njëjtën kohë ky konflikt duhet të zgjidhet brenda rregullave, kodeve, ligjeve të caktuara dhe të sjellë kompromisin, konsensusin apo marrëveshje të tjera ndërpartiake, që gjykohen nga të gjitha palët si të ligjshme e të pa kontestuara. Për të gjitha këto që thamë kërkohet, në themel, kulturë politike, gjë që në shqiptarëve ende na mungon. Në qoftë se grupet, individët, partitë politike etj, e shikojnë demokracinë në rastin tonë, në Shqipëri, vetëm si forum ku ata kërkojnë realizimin e interesave, kërkesave të ngushta personale, shoqëria në tërësi është e destinuar të shkatërrohet nga brenda në mënyrë katastrofale. Ky është fakt dhe realiteti i pamohueshëm në Shqipëri.

Në qoftë se qeveria, siç po ndodh me qeverinë e sotme demokratike që administron zgjedhjet e reja parlamentare ushtron mbi votuesit dhe kandidatet e votuar nga ai, presion, dhune policore, shantazhe etj. për arritjen e konsensusit, duke ngritur zërin dhe të drejtat e tij demokratike, atëherë shoqëria shqiptare në rastin konkret, do të shkatërrohej nga lart në sajë të një diktati antidemokratik. Demokracia, sidomos në Shqipëri, nuk funksionon realisht vetvetiu duke përdorur parimet apo procedurat teknike të votimit, kur ende ekzistojnë mentalitet dhe praktikat komuniste të etjes për pushtet të përjetshëm. Shoqëria demokratike shqiptare kan nevojë për përkushtimin e qytetarëve të kulturave, të cilët duhet ta kuptojnë pashmangësinë e konfliktit e sidomos në zgjedhje, dhe domosdoshmërinë e tolerancës. Në realitetin e sotëm shqiptar, ka rëndësi të kuptohet se shumë konflikte në shoqërinë demokratike shqiptare nuk lindin nga një kundërvënie e prerë midis dy pikëpamjeve, bindjeve politike etj, ku njëra gjykohet si "e drejtë" dhe tjetra "e gabuar", por në themel të dy interpretimeve të ndryshme dhe të të drejtave demokratike, të interesave dhe parësive shoqërore. Kjo është arsyeja që zhvillimi i kulturës politike-demokratike ka rëndësi shumë të madhe për individët, grupet shoqërore në demokraci me frymë kompromisi dhe parimin e përgjithshëm të sundimit të shumicës dhe të të drejtave të pakicës. Krijimi i koalicioneve është thelbi, çelësi i zgjidhjeve dhe veprimit demokratik. Ky sistem realizon kompromisin dhe konsensusin politik të palëve, grupeve dhe të punojnë brenda kuadrit kushtetues.

Reformimi i kulturës politike shqiptare

Sikundër shprehet një nga protagonistët e politikës shqiptare të viteve 90-të: “[q]ë një sistem partiak të arrijë nivele bashkëkohore pjekurie, emancipimi dhe zhvillimi duhet pikësisht dhe një reformim i kulturës politike shqiptare krahas faktorëve të tjerë. Rritja e interesit për kulturën politike është plotësisht e përligjur në një shoqëri demokratike” (Pëllumbi 2006: 162-170). Ndërsa për një shoqëri në tranzicion, çdo hap përpara, sukcesi apo mosesukcesi i një reforme të vetme e aq më tepër i një kompleksi reformash në fushën ekonomike, në sistemin politik apo në jetën shpirtërore, reflektojnë nivelin e kulturës politike. Jo rastësisht ky ka lindur si koncept pikërisht në periudhën e iluminizmit, kur u hodhën edhe bazat e funksionimit të demokracisë pluraliste. Iluministi i njohur gjerman I.G. Herder (1744-1804), e përdori për herë të parë konceptin “kulturë politike”, që gradualisht ka marrë një përmbajtje e që e dallon në vartësi të këndvështrimit të politologëve të ndryshëm. Në përmbajtjen e vet, kultura politike përfshin në të gjitha rastet tërësinë e vlerave më të mira, idetë, bindjet, orientimet që i shërbejnë transformimit të shoqërisë, sistemit të përvojës politike, rregullimit të sjelljes politike, të grupeve sociale, të partive, të institucioneve shtetërore dhe të individëve (Verba & Almond 1963). Kultura politike, thënë shkurt, sintetizon në vetvete së pari, mënyrat më të mira për të bërë një zgjedhje politike dhe së dyti mënyrat më të mira të veprimit politik. Nga këto dy nivele-nga kultura e të menduarit dhe kultura e sjelljes-varen në një masë të konsiderueshme raportet midis njerëzve. Studiuesit Verba & Almond (1989) duke e rrokur më ngushtë këtë koncept, vetëm si “kulturë të qytetarit”, e vënë theksin te përmbajtja e orientimeve politike, te dijet, njohuritë e qytetarit për politikën, për partitë, për institucionet politike, përfshi edhe ndjesitë, simpatitë dhe antipatitë e tij politike, duke nënvizuar politikën e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve, pa të cilat, siç dihet, nuk ka shoqëri civile. Në këtë rast vlerësohet posaçërisht kërkesa e qytetarëve për të qenë të informuar për veprimtarinë e qeverisë, të partive politike dhe të elitës politike, aftësia e qytetarëve për të përdorur normat, aktet dhe dispozitat ligjore, për të reaguar ndaj çdo arbitrariteti të pushtetit duke shprehur hapur e në mënyrë luajale opinionet opozitare.

Ballafaquar me një kuptim të tillë të kulturës politike, idealiste e pluraliste njëherësh, një vëzhgues i vëmendshëm nuk do ta kishte shumë të vështirë të gjykonte për nivelin e kulturës politike në Shqipëri dhe të përcaktonte disa nga drejtimet kryesore të reformimit të saj. Para së gjithash, e rëndësishme është që vetë politikanët ta pranojnë hapur se te ne ende nuk mund të flitet për një kulturë politike pluraliste dhe adekuate për një demokraci normale. Ajo vazhdon të jetë në një stad formësimi, disi amorfë, shoqëruar me nostalgji për të kaluarën, por dhe me zhgënjime për të sotmen, madje e parcelizuar sipas partive. Vëzhgimi empirik konstaton se përqindja e njerëzve që i tërheq politika dhe që marrin pjesë në jetën aktive politike, është relativisht i ulët: vetëm 12.9%. Për disa nga të anketuarit, termat “politikë” e “politikan” bashkëshoqërohen me fjalët “hile” e “hileqar”, me ata që fitojnë pa punuar, që japin premtime dhe nuk i mbajnë. Asociime e ndjesi të tilla bëjnë që njerëzit ti largohen politikës.

Ndërkohë, dhe fobia ndaj intelektualëve rritet. Mbi 100 mijë shqiptarë me arsim të lartë, tashmë janë shndërruar në një tregues të harruar statistikorë. Mbi 40% e tyre kanë emigruar jashtë, 70% e stafit pedagogjik të universiteteve, sipas një sondazhi, parapëlqejnë të emigrojnë. Analfabetizmi po merr përmasa shqetësuese, sepse po shkon 15-20%. Duke iu referuar qoftë edhe vetëm kësaj lloji varfërie, del se po jetojmë në një situatë kritike. Nuk do të isha plotësisht dakord me konkluzionin e politologut të njohur S. Huntington, kur thotë se interesat ekonomike nuk kanë më rëndësi parimore. Por mendoj se duhet çmuar ideja e tij për rritjen e rolit të kulturës e të jetës shpirtërore, si faktor që i mban njerëzit të bashkuar dhe i motivon në veprimtarinë e tyre. Në këtë linjë, duke iu referuar rastit tonë, do thoja se vërtet varfëria ekonomike është shkaku i tensioneve politike e sociale, pra i dobësimit të patriotizmit shqiptarë, por edhe varfëria shpirtërore, nga ana e vet, s’është vetëm pasojë, por edhe shkak i saj.

Mbase duket paradoksale, por është fakt, që vërtetohet edhe në rastin tonë, se popujt, ashtu si dhe qeveritë, kërcënohen nga ndryshimet, të cilat kur bëhen të pamenduara mirë, shpesh shoqërohen me drama, me plagë sociale jo të vogla e jo lehtësisht të shërueshme. Aq më keq nëse dikujt i intereson vetëm drama si e tillë, dikujt tjetër vetëm aktorët, apo një të treti vetëm regjisori. Spontaniteti në këtë fushë ushqehet edhe nga një keqkuptim konceptual e metodologjik, sipas të cilit ekonomia e lirë e tregut, larmia e pronës private, ndryshimet ekonomike-sociale, liria e individit, e iniciativës private dhe pluralizmi politik çojnë vetvetiu në formimin e kulturës në përgjithësi, pra dhe të kulturës politike që na duhet. Një gjë e tillë, edhe sikur të ishte e mundur e të ndodhte një ditë, do të kërkonte patjetër shumë kohë. “Një shoqëri nuk mund të bëhet një shoqëri e mirë,-- do të thoshte Hare (1999)-- që në fillimet e tranzicionit në vendet e lindjes, thjesht duke respektuar të drejtat e pjesëtarëve të vet. Një shoqëri e mirë bën diçka më tepër se kaq. Ajo përpunon një mjedis kulturor, që është i favorshëm për zhvillimin e aftësive karakteristike njerëzore” (Hare 1999: 46). Kultura politike, ashtu si kultura në përgjithësi, ka rrugën e dinamikën e vet dhe një pavarësi relative në raport me ndryshimet ekonomike-shoqërore, me rotacionin e pushtetit apo me qenien e partive të reformuara apo të pa reformuara. Në varësi të kësaj, siç vëren politologu tashmë i cituar Hare R.M., “njerëzit fillojnë e bëhen të rrezikshëm pikërisht kur kalojnë nga rendja egoiste pas interesave të tyre, në propagandimin e idealeve të degraduara”. Bindemi më tej për pavarësinë relative dhe rolin aktiv të kulturës politike po të jetë se do t’u referohemi disa prej kërkesave e funksioneve që ka kultura politike. Ajo është një përqendrim vëmendjeje ndaj të vërtetave themelore, prandaj dhe kërkon që qytetarët të jenë politikisht aktiv në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të tyre, por që edhe të dëgjohen rregullisht. Kultura politike nuk e favorizon besimin e verbër te partia dhe as te mitet e piedestalet për liderë të veçantë politikë. Kjo mbase e vështirëson qenien, sepse liderët politikë shpesh e marrin si të mirëkuptuar mbështetjen politike të qytetarëve, duke llogaritur vetëm premtimet që bëjnë, veçanërisht gjatë fushatave elektorale. Mbas një parashtimi teoriko-praktike të çështjes së kulturës, veçanërisht të asaj politike, do ta quaja të domosdoshme të theksoj, në vend të përfundimeve, edhe disa nga drejtimet ku duhet të synojmë në stadin e sotëm të konsolidimit të demokracisë pluraliste shqiptare.

Konkluzionet

Si përfundim mund të themi se në Shqipëri dhe Maqedoni ende mungon kultura politike, jo vetëm në partitë politike por sidomos tek masat. Kultura politike normalisht krijohet ngadalë sepse siç do lloj kulture varet nga tradita, por tek ne pavarësisht se e kemi nga pikëpamja kohore një traditë politike ende nuk mund të flitet për kulturë politike. Mungesa e kulturës politike, kjo “pagdhenduri” politike, duhet parë si pasojë e mosfunksionimit të procesit politik. Çdo parti politike që ka qarkulluar në këto 100 vjet, nuk është kujdesur qoftë edhe për një sekondë, për të lënë mbrapa një teori politike me vlere të posaçme për shoqërinë shqiptare dhe maqedonase, zakonisht janë riciklime të teorive që gjenden rëndom jashtë vendit. Partitë politike në Shqipëri janë marrë pothuajse vetëm me teorinë e mbajtjes së pushtetit me çdo kusht dhe politologët e së shkuarës janë kufizuar në atë drejtim. Kjo gjë ndodh për fat të keq edhe sot, politologët e sotëm merren zakonisht me teorinë e mbajtjes së pushtetit, si me zhvillimin dhe me kritikën e saj. Kjo tregon se marrja e mbajtjes së pushtetit është i vetmi qëllim ku drejtohen energjitë mendore të partisë politike. Kjo ka krijuar edhe tek masat idenë se politika nuk është gjë tjetër përpos marrja dhe mbajtja e pushtetit e logjikisht të merresh me politikë nënkupton të kesh mundësinë e privilegjeve. Kjo mendësi është rrënjësuar aq thellë në ndërgjegjen shqiptare, saqë vetë procesi i shtresëzimit i cili sjell edhe kulturën politike, pra në një farë mënyre ne e kemi dënuar vetë veten me pagdhendurinë politike, madje aq shumë saqë është krijuar edhe një lloj njësie matëse për aftësitë politike të njërit apo tjetrit. Nëse nuk ndryshohet kjo mënyrë e të perceptuarit për politikën nuk ka gjasa të ndryshojë edhe veprimtaria politike në Shqipëri dhe Maqedoni, ku pagdhenduria politike do udhëheqë votuesin në kutinë e votimit. Kuptohet që çdo votë e tillë shqiptarëve mbi të mirën e përbashkët e mënyrën se si arrihet tek ajo.

Kultura politike dhe dialogu në Maqedoni janë në formë të mjerueshme dhe vazhdimisht keqësohen tensionet midis partive politike në pushtet duke sjellë pasiguri dhe tensione midis njerëzve. Partitë politike në Maqedoni dhe vlerat morale që ato praktikojnë janë faktorët kyç që e ndikojnë kulturën politike. Pra do shtoja se pavarësisht se në Shqipëri kemi një pjesëmarrje të lartë në votime përsëri vihet re një hendek i madh midis votës së zgjedhësit dhe përfaqësuesit i cili voton i painformuar dhe më pas zhgënjehet si rezultat i pritshmërive, po ashtu dhe në Maqedoni nuk kemi një përparim të kulturës politike dhe kjo si rezultat i fragmentarizmit të partive plus faktorë të tjerë. Së fundi, kërkohet një sensibilizim më i madh i elitës intelektuale, i politikanëve, i institucioneve studimore të politikës, shumica e të cilëve, fatmirësisht, janë të pavarur nga shteti. Roli i tyre është i pazëvendësueshëm në një riorganizim serioz dhe reformim të kulturës politike.

Bibliografia

- Almon, Gabriel & Sydney Verba. 1989. *The Civic Culture: Political Attitudes and Democracy in Five Nations*. SAGE Publications, Inc.
- Bardhi, R, Ndini. 2013. *Kultura Qytetare dhe demokratike në Shqipëri*, WestPRINT, Tiranë.
- Feraj, Hysamedin. 2007. *Hyrje në shkencat politike*, PEGI, Tiranë.
- Gashpar, Tomash. 1998. *Trashëgimia e disidencës*. Në filozofia dhe tranzicioni Arbri, Soros, Tiranë.
- Hare.R.M. 1999. Utilitarizmi, cit nga libri i Janos Kis: *Filozofia politike bashkëkohore*, Tiranë: Onufri.
- Huntington, Samuel. 2011. *The Clash of Civilizations and the Remaking of World Order*. Simon & Schuster.
- Huntington, Samuel. 1993. *The Third Wave: Democratization in the Late 20th Century* University of Oklahoma Press.
- Hyska, Eva. 2008. *Tranzicioni politik në Europën Qëndrore dhe Lindore*, SHBLU, Tiranë.
- Linz, Juan & Alfred Stepan. 1996. *Problems of Democratic Transition and Consolidation: Southern Europe, South America, and Post-Communist Europe*. John Hopkins University Press.
- Mano, S, Minella. 2005. *Konkurimi dhe të drejtat në demokraci*, LOGORECI.
- Koçani, Aleksander. 2003. Flaka, *Vajtja në Europë dhe kultura qytetare demokratike*, Tiranë.
- Krasniqi, Afrim. 2012. *Sjellja zgjedhore dhe identifikimi i votës në Shqipëri*, Konica, Tiranë.
- Krasniqi, Afrim. 2009. *Zgjedhjet në Shqipëri 1991-2008*, Konica, Tiranë.
- Pëllumbi, Servet. 2006. *Puralizmi politik*, Insituti i Sociologjisë.
- “*Identiteti dhe integrimi*”, Revista Politika&Shoqëria, 2006, vëll.9.
- Ukaj, Ndue. 2010. Kritika, *Politika dhe kultura*, Tiranë.
- Veselaj, Arben. 2002. Albania, *Kultura e fragmentarizuar shqiptare*, Tiranë.
- Vajdenfeld, Verner. 1999. *Demokracia dhe Ekonomia e Tregut në Europën Lindore*, Fondacioni Soros, Tiranë.
- Wojtek, Lamentoicz. 1999. *Paqëndrueshmëria politike në Europën Qëndrore dhe Lindore, dhe rreziqet e brendshme politike të integritetit dhe sigurisë Europiane*, Tiranë: L&s, Soros.

NJOHJA E STANDARDEVE PËR MËSUES NGA DREJTUESIT DHE MËSUESIT NË SHKOLLA

DR.ARANIT GJIPALI

Universiteti "Ismail Qemali" Fakulteti i Shkencave Humane, Përgjegjës Departamenti Edukimit. E-mail: aranit_gjipali@yahoo.it

PROF. AS. ALEKS TRUSHAJ

Universiteti "Ismail Qemali" Fakulteti i Shkencave Humane, Dekan I Fakultetit. E-mail: atrushaj@yahoo.com

PHD CANDIDATE ILVA LAMAJ

Universiteti "Ismail Qemali" Fakulteti i Shkencave Humane, lektore psikologji sociale Departamenti i Edukimit. E-mail: ilva83@hotmail.it

PHD CANDIDATE ENKELEJDA BILLA

Universiteti "Ismail Qemali" Fakulteti i Shkencave Humane, lektore Histori, Departamenti i Edukimit. E-mail enkelejda.billa@yahoo.com

ABSTRAKT

Gjatë eksperiencës sonë si mësues është ndier gjithmonë nevoja e përdorimit të standardeve për të realizuar një vlerësim real të besueshëm e të pakontestueshëm nga mësuesit. Qëllimi i këtij punimi konsiston në domosdoshmërinë e standardizimit të profesionit të mësuesit në funksion të përmirësimit të cilësisë së shkollimit të nxënësve; Njohja dhe efektiviteti i përdorimit të standardeve për mësuesin në arsimin parauniversitar shqiptar dhe problematika që bart, krahasuar me problematikën që bart arsimit Europian; Ndikimi i përdorimit të standardeve për mësues në vlerësimin e performancës së mësuesit dhe në krijimin e një klime pozitive në klasë. Popullata e studimit është e përbërë nga drejtues dhe mësues të shkollave të Qarkut Vlorë (Vlorë, Sarandë, Delvinë). Për këtë studim u përdor një pyetësor i strukturuar. Për këtë studim u përdor një pyetësor i strukturuar që përmban 3 pjesë. Në pjesën e parë, pyetësori përfshin karakteristika të përgjithshme të mësuesve dhe të shkollës. Në pjesën e dytë pyetësori përmban pyetje për lidhjen e standardeve me stilet e mësimdhënies në klasë. Në pjesën e tretë pyetësori përmban treguesit e Pyetësorit Përshkrues Organizativ të Klimës në klasë në lidhje me përdorimin e standardeve për mësues. Të dhënat u analizuan me anë të Paketës Statistikore për Shkencat Sociale (SPSS). Rezultatet tregojnë se përdorimi i standardeve për mësues lenë për te dëshiruar gjë që çon në ndikimin mbi stilet e mësimdhënies dhe klimën në shkollë. Përdorimi i standardeve përmirëson stilin e mësimdhënies të mësuesit në klasë. Përdorimi i standardeve për mësues përmirëson, nxit klimën e hapur në shkollë dhe forcon perceptimin e mësuesve, se institucioni është i hapur dhe bashkëpunues.

Fjalë kyç: *Stile të mësimdhënies, klima në shkollë, standardet për mësues, sjellja e mësuesve, sjellja e drejtuesve.*

Hyrja

Punimi merr nxitjen dhe mbështetet kryesisht në përvojën e drejtimit, kontrollit dhe vlerësimit në arsimin parauniversitar shqiptar të ndarë në periudhën para viteve 1990, vitet 1990-2000 dhe pas viteve 2000 deri më sot. Para vitit 2004 kontrolli ndërtohej dhe kryhej mbështetur në ligjet, planet, programet dhe eksperiencat e përparuara në arsimin shqiptar duke i mëshuar më shumë drejtimit të shkollës, mësimdhënies dhe disiplinës në shkollë. Rezultatet e të nxënësve zinin vend të veçantë përmes testimeve të kryera nga inspektorët. Me krijimin e drejtorisë së inspektimit në MASH në zbatim të Strategjisë së zhvillimit të arsimit në Shqipëri, botimit të Manualit të inspektimit, u krijua një strukturë e plotë pune për vlerësimin e jashtëm të cilësisë së shkollës, pjesa themelore e të cilës është Tabloja e vlerësimit e cila përmban fushat dhe karakteristikat përkatëse të cilësisë së shkollës. Manuali i inspektimit është i përdorshëm jo vetëm nga inspektorët por edhe nga drejtuesit e shkollës për të kryer vlerësimin e brendshëm të cilësisë së shkollës në katër fushat kryesore: a- Menaxhimi dhe administrimi. b- Procesi i mësimdhënies dhe të nxënësve c- Kujdesi për nxënësit d- Rezultatet e nxënësve. Gjithashtu drejtuesit dhe mësuesit të njohin, të përvetësojnë dhe të zbatojnë hap pas hapi standardet e përgjithshme për mësues dhe më tej ato të programeve lëndore. Kjo i ndihmon edhe drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitare që të përmirësojnë stilin e tyre të drejtimit për t'iu përgjigjur zhvillimeve të reja në arsim, standardeve, teknologjisë së informacionit, dhënien e rëndësisë faktit që shkolla i përket komunitetit, drejtimit kolegjal të institucionit arsimor etj.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij studimi është:

Domosdoshmëria e standardizimit të profesionit të mësuesit në funksion të përmirësimit të cilësisë së shkollimit të nxënësve.

Njohja dhe efektiviteti i përdorimit të standardeve për mësuesin në arsimin parauniversitar shqiptar dhe problematika që bart, krahasuar me problematikën që bart në arsimin Europian.

Ndikimi i përdorimit të standardeve për mësues në vlerësimin e performancës së mësuesit dhe në krijimin e një klime pozitive në klasë.

Rishikimi dhe riformatimi i sistemit ligjor të sistemit arsimor parauniversitar në Shqipëri në përputhje me politikat e zhvillimit të arsimit në Shqipëri në sinkron me zhvillimin e arsimit në Europë dhe më gjerë.

Rishikimi i strukturave drejtuese dhe përgjegjëse në MASH, DAR, ZA duke parë mundësinë e krijimit të një Këshilli Arsimor që të ndjekë politikën e hartimit, rishikimit dhe vlerësimit të standardeve për mësues.

Përfundimet e këtij studimi do të kontribuojnë në pritshmërinë e aktorëve të ndryshëm mbi profesionin e mësuesit dhe mësuesin si profesionist.

Kështu që, ky studim do të ndihmojë drejtuesit të cilët për një arsye ose një tjetër nuk kanë qenë efektivë në njohjen dhe përdorimin e standardeve për mësues dhe si rezultat nuk kanë punuar në mënyrë eficiente në përmirësimin e performancës së shkollës.

Punimi do të gjejë rrugëzgjdhje nëpërmjet të cilave drejtuesit e shkollave publike të sistemit parauniversitar në Shqipëri do të mund të përmirësojnë performancën e tyre të drejtimit. Përfundimet e këtij punimi do t'i shërbejnë studimeve të mëtejshme që do të realizohen në këtë fushë.

Punimi evidenton domosdoshmërinë e standardizimit të profesionit të mësuesit në funksion të licencimit të tij. Punimi ka për qëllim të zbulojë efikasitetin e përdorimit të standardeve të mësimdhënies për mësues në arsimin parauniversitar shqiptar. Objektivat e këtij punimi janë të përmbledhura si më poshtë:

- ← Hulumtimi në literaturën bashkëkohore (kombëtare dhe ndërkombëtare) mbi standardet për mësues

- ← Rekomandime për përmirësimin e përdorimit të standardeve në shkollën shqiptare, në funksion të përmirësimit të cilësisë së shkollimit të nxënësve mbas gjetjeve të studimit.

Ky hulumtim e vë theksin mbi mësuesin si profesionist në zhvillim të vazhdueshëm.

Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Çështjet e ngritura në këtë studim kanë të bëjnë me rolin e rëndësishëm të standardeve për mësues në funksion të përmirësimit të cilësisë së shkollimit të nxënësve në arsimin parauniversitar.

- ← Sa të nevojshme janë standardet?
- ← Si është gjendja e sotme e vlerësimit?
- ← Çfarë e bën të dallohet në vlerësim punën e mësuesit?
- ← Sa njihen standardet për mësues nga drejtuesit dhe mësuesit në shkollë?
- ← Sa dhe si përdoren standardet nga mësuesit në veprimtarinë e tyre të përditshme në shkollë?

Punimi është kryer duke marrë të dhëna nga 75 institucione arsimore publike, i cili për nga numri dhe shtrirja gjeografike, konsiderohet të jetë përfaqësues i të gjithë komunitetit të institucioneve arsimore publike parauniversitare në Shqipëri.

Popullata në studim janë mësuesit dhe drejtuesit e të gjitha institucioneve arsimore publike të sistemit parauniversitar të Shqipërisë. Kampioni u përzgjedh me teknikën “Stage” dhe “Cluster Sampling”.

Për arsye të një përfaqësimi sa më të gjerë, popullata në shkallë vendi u nda në 6 grupe kryesore. Në mënyrë rastësore, nga çdo grup (përfshirë të 3 qarqe të vendit) u zgjodhën 75 kopshte dhe shkollë në fshat dhe në qytet. Në plotësimin e pyetësorit u përfshinë një pjesë e drejtuesve të shkollave të përzgjedhura dhe në mënyrë rastësore u përzgjedhën mësuesit e këtyre shkollave. Në kampion u përfshinë 75 institucione nga 9 rrethe, konkretisht: Vlora, Saranda, Delvina, Fieri, Lushnja, Mallakastra, Berati, Skrapari, Kuçova.

Pyetësorët u plotësuan gjatë kohës që mësuesit kishin përfunduar orët e mësimit dhe në prani të studiuesit ose të personave ndihmës të tij. U patën parasysh:

- ← shkollë në zona rurale dhe urbane,
- ← shkollë me numër të konsiderueshëm nxënësish,
- ← kopshte në zonën urbane.

Cohen, Manion dhe Morrison (2001) pohojnë se e gjithë popullata duhet të ndahet në grupe homogjene dhe çdo grup të ketë karakteristika të krahasueshme. Duke qenë se pothuajse mësuesit kanë karakteristika të njëjta, në studim morën pjesë mësuesit nga shkollë të zonave rurale e urbane.

Në reflektim të kësaj, analiza dhe diskutimi i përgjithshëm i këtij studimi sillet rreth Mësuesve dhe drejtuesve të përzgjedhur në mënyrë rastësore të institucioneve arsimore publike të Shqipërisë.

Në përzgjedhjen e mësuesve, u përdor teknika e zakonshme e përzgjedhjes rastësore duke përdorur kompjuterin i cili bëri një përzgjedhje ndërmjet mësuesve të secilës shkollë të renditur më parë sipas listës së shkollës, në varësi të raportit të përzgjedhjes për çdo shkollë (1:3 ose 1:4), në varësi të numrit të mësuesve.

Të dhënat u mblodhën mbi njohjen dhe përdorimin e standardeve, në një pyetësor të strukturuar. U zhvilluan pyetësorë sasiorë tek mësuesit, duke përdorur shkallën e tipit-Likert. Pyetësori në vetvete, konsiderohet i përshtatshëm, pasi konsiderohet i dobishëm në mbledhjen e të dhënave mbi ndjesitë dhe perceptimet e një grupi njerëzish (Peers 1996).

Kështu, pyetësori u përdor për të kërkuar informacion më shumë rreth perceptimeve të mësuesve për sa i përket njohjes dhe përdorimit të standardeve për mësues, ndikimit që ka njohja dhe përdorimi i

← Cohen, L., Manion, L. & Morrison, K. (2001). Research Methods in Education

standardeve për mësues. Instrumenti kryesor është pyetësi për njohjen dhe zbatimin e standardeve nga mësuesit sipas arsimit dhe kualifikimit (pozicionit të tij në shkollë).

Pyetësi është marrë nga (*monkey survey*) dhe janë përdorur në studime për vlerësimin e efikasitetit të standardeve për mësues në Itali, Angli etj. Pyetjet e informacionit të përgjithshëm konsistojnë në: Gjininë e pjesëmarrësve në studim, arsimimin e tyre dhe zonave urbane apo rurale.

Njëra nga pyetjet kërkon vjeljen e informacionit për grupmoshat e pjesëmarrësve në studim duke i ndarë ato si më poshtë: Grupi i parë 22-30 vjeç, Grupi i dytë 30-40 vjeç, Grupi i tretë 40-50 vjeç, Grupi i katërt 50-60 vjeç dhe Grupi i pestë 60-65 vjeç.

Analizë, interpretim të dhënash

Në pyetësin e plotësuar nga mësuesit dhe drejtuesit e shkollave u përdorën dy pyetje të ndara nga njëra tjetra: e para, sa njihen standardet për mësues nga personeli i shkollës dhe e dyta a përdoren ato nga mësuesit në punën e tyre? Rezultati për njohjen e standardeve tregon se 96.5% i njohin ato dhe 3.5 % nuk e dinë që përdoren standardet për mësues në shkollë. (Shih tabelën e frekuencës)

TABELA NR. 1 . A JENI NË DIJENI TË STANDARDEVE TË MËSUESIT?

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja e grumbulluar
Vlerat	PO	724	96.5	96.5	96.5
	JO	26	3.5	3.5	100.0
	Total	750	100.0	100.0	

Shkaku i mosnjohjes është si pasojë e neglizhencës së drejtuesve të shkollave për këtë problem. Nëse do t'i kishim të afishuara në ambientet e shkollës edhe ne do t'i njihnim ato, shprehen mësuesit. Për sa i përket pyetjes së dytë lidhur me përdorimin e standardeve treguesit janë më negativë sesa njohja e tyre.

Referuar tabelës së frekuencave nr. 2 shikojmë se 69.3% e mësuesve përdorin standardet në punën e tyre dhe 30.7% nuk i përdorin ato, gjë që tregon se, nga drejtuesit e institucioneve në veçanti, nuk është bërë puna e duhur për futjen e elementëve të rinj në punën e mësuesit, që do të çojë në rritjen e performancës në punën e tyre dhe përmirësimin e cilësisë së shkollimit të nxënësve.

TABELA NR. 2. A PËRDORNI STANDARDET PËR MËSUES NË PUNËN TUAJ?

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja e grumbulluar
Vlerat	a	520	69.3	69.3	69.3
	b	230	30.7	30.7	100.0
	Total	750	100.0	100.0	

Me përdorimin e standardeve për mësues në shkollë detyrimisht reflektimi i parë do të jetë mbi mënyrën e kontrollit të drejtuesve të shkollës. Rezultati i marrë nga studimi është si më poshtë në tabelën e bashkëlidhur. Nga studimi i tabelës nr. 3 shihet se 84.8% janë në dijeni të ndryshimeve në format e vlerësimit nga drejtuesit e shkollave, nën efektin e përdorimit të standardeve kurse 15.2% nuk kanë dijeni për ndryshimet,

TABELA NR. 3. A JENI NË DIJENI TË FORMAVE DHE METODAVE TË VLERËSIMIT QË PËRDOREN NGA DREJTUESIT?

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja e grumbulluar
Vlerat	PO	590	78.7	84.8	84.8
	JO	106	14.1	15.2	100.0
	Total	696	92.8	100.0	
Të humbura	Sistem	54	7.2		
	Total	750	100.0		

Nëse nën efektin e përdorimit të standardeve ka ndryshuar politika e administrimit dhe vlerësimit në shkollë?

Nga përgjigjet rezulton se: 32.3% e pjesëmarrësve kanë vënë re ndryshimet, kurse 67.7% nuk kanë vënë re asnjë ndryshim. (shih tabelën nr. 4)

TABELA NR. 4 . NËN EFEKTIN E PËRDORIMIT TË STANDARDEVE PËR MËSUES, KA NDRYSHUAR POLITIKA E ADMINISTRIMIT DHE VLERËSIMIT NË SHKOLLË?

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja e grumbulluar
Vlerat	PO	242	32.3	32.3	32.3
	JO	507	67.6	67.7	100.0
	Total	749	99.9	100.0	
Të humbura	Sistem	1	.1		
Total		750	100.0		

A ju është thënë mësuesve se performanca e tyre në periudhën në vazhdim do të vlerësohet edhe sipas standardeve për mësues? Pjesëmarrësit janë përgjigjur 85% se ju është thënë dhe 15% nuk e dinë.

TABELA NR. 5. A JU ËSHTË THËNË SE NË PERIU DHËNË NË VAZHDIM PERFORMANCA JUAJ DO TË VLERËSOHET DHE SIPAS STANDARDEVE TË MËSUESIT?

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja e grumbulluar
Vlerat	PO	580	77.3	85.0	85.0
	JO	102	13.6	15.0	100.0
	Total	682	90.9	100.0	
Të humbura	Sistem	68	9.1		
Total		750	100.0		

Nëse ka ndryshuar organizimi i kontrollit mësues në shkollë që prej prezantimit të standardeve për mësues në tabelën e bashkëlidhur shohim se 56.8% kanë vërejtur ndryshimet dhe 43.2% nuk kanë vërejtur asnjë ndryshim

TABELA NR. 6. A KA NDRYSHUAR ORGANIZIMI KONTROLLIT MËSIMOR NË SHKOLLË QË PREJ PREZANTIMIT TË STANDARDEVE PËR MËSUES?

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja e grumbulluar
Vlerat	PO	425	56.7	56.8	56.8
	JO	323	43.1	43.2	100.0
	Total	748	99.7	100.0	
Të humbura	Sistem	2	.3		
Total		750	100.0		

Normalisht një drejtues i aftë dhe njohës i mirë i gjendjes në institucionin arsimor që drejton duhet të jetë transparent në punën e tij dhe në format e punës që përdor.

A do të jetë i efektshëm përdorimi i standardeve për identifikimin e performancave të dobëta në shkollë nga ana e drejtuesve? Përgjigjet janë dhënë në një shkallë Likert në tabelën nr 24

TABELA NR. 7. A MENDONI SE FORMA E RE PËR KONTROLLIN E PERFORMANCËS SË MËSUESIT E PREZANTUAR ME STANDARDET DO TA THJESHTOJË/VËSHTIRËSOJË PUNËN E SHKOLLËS NË IDENTIFIKIMIN E PERFORMANCAVE TË DOBËTA?

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja e grumbulluar
Vlerat	SHUMË E LEHTË	145	19.3	19.4	19.4
	DISI MË E LEHTË	172	22.9	23.0	42.3
	S'KA EFEKT	102	13.6	13.6	55.9
	DISI E VËSHTIRË	154	20.5	20.6	76.5
	SHUMË E VËSHTIRË	86	11.5	11.5	88.0
	NUK E DI	90	12.0	12.0	100.0
	Total	749	99.9	100.0	
Të humbura	Sistem	1	.1		
Total		750	100.0		

Entuziastë janë 61.7% e pjesëmarrësve, pa efekt e shikojnë 13.6%, të pavendosur janë 12% dhe 32.1% e shikojnë si të vështirë për të mos thënë të pamundur.

TABELA NR. 8. A MENDONI SE FORMA E RE PËR KONTROLLIN E PERFORMANCËS SË MËSUESIT E PREZANTUAR ME STANDARDET DO TA THJESHTOJË/VËSHTIRËSOJË PUNËN E SHKOLLËS NË TRAJTIMIN E PERFORMANCAVE TË DOBËTA?

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja e grumbulluar
Vlerat	SHUMË E LEHTË	148	19.7	19.7	19.7
	DISI MË E LEHTË	168	22.4	22.4	42.1
	S'KA EFEKT	104	13.9	13.9	56.0
	DISI E VËSHTIRË	150	20.0	20.0	76.0
	SHUMË E VËSHTIRË	85	11.3	11.3	87.3
	NUK E DI	95	12.7	12.7	100.0
	Total	750	100.0	100.0	

42.1% e pjesëmarrësve e shikojnë me pozitivitet trajtimin e performancave të dobëta me përdorimin e formave të reja të kontrollit në zbatim të standardeve për mësues, 13.9% e shikojnë si të pa efektshme, 31.3% e shikojnë të vështirë për të mos thënë të pamundur dhe 12.7% nuk kanë asnjë mendim. Nga rezultatet e studimit shikojmë se 96.5% e pjesëmarrësve në studim i njohin standardet për mësues dhe 3.5 % nuk e dinë që përdoren standardet për mësues në shkollën ku punojnë. Treguesi 96.5% është i kënaqshëm dhe tregon se mësuesit në sistemin arsimor parauniversitar në Shqipëri janë informuar ndryshimet në arsim. Ende është i nevojshëm kujdesi për informimin e të gjithë mësuesve për përdorimin e standardeve në punën e tyre ashtu siç informohen për ndryshimet në tekste apo programe mësimore. Drejtuesit e shkollave janë 100% të informuar për faktin se ata janë në kontakt të drejtpërdrejtë me informacionin që vjen nga MAS apo DAR/ZA. Problemi qëndron në përcjelljen e informacionit të mësuesi dhe kontrollin e zbatimit të tij, i referohem 3.5% të mësuesve të painformuar

Përsa i përket përdorimit të standardeve nga mësuesit rezultatet nuk janë të kënaqshme 69.3% i përdorin ato në punën e tyre kurse 30.7% nuk i përdorin. Janë rreth 230 mësues nga 750 anketuar, një numër i konsiderueshëm që flet për një punë jo të mirë informuese dhe kontrolluese nga ana e drejtuesve të shkollave dhe personave përgjegjës për kualifikimin në DAR/ZA. Mungesa e kontrollit të jashtëm në institucionet e arsimit parauniversitar bën që drejtuesit të mos e kryejnë detyrën e tyre në të gjithë dimensionin e saj.

A janë mësuesit në dijeni të formave dhe metodave të vlerësimit? 84.8% janë në dijeni të ndryshimeve në format e vlerësimit nga drejtuesit e shkollave, nën efektin e përdorimit të standardeve kurse 15.2% nuk kanë dijeni për ndryshimet gjë që tregon se veprimtaritë kualifikuese dhe njohëse për ndryshimet në arsim duhet të jenë më të shpeshta, të organizuara dhe të kontrollohet zbatimi i udhëzimeve të dhëna.

Nëse ka ndryshuar organizimi i kontrollit mësues në shkollë që prej prezantimit të standardeve për mësues, 56.8% kanë vërejtur ndryshimet dhe 43.2% nuk kanë vërejtur asnjë ndryshim. Rezultati përsëri tregon një punë të shkëputur të drejtuesve të institucionit nga mësuesit. Tregon për një stil drejtimi të mbyllur, pedant dhe një shkëputje artificiale të punës së drejtuesve nga puna e çdo mësuesi.

Për organizimin e kontrollit në zbatim të standardeve për periudhën në vazhdim, 85% e mësuesve pohojnë se iu është thënë dhe 15% nuk kanë asnjë informacion. Përsëri problemi mendoj, se qëndron në marrëdhëniet e komunikimit të vendosura ndërmjet mësuesve dhe drejtuesve të shkollave, marrëdhënie që padyshim ndikojnë edhe në klimën që krijohet në shkollë dhe në klasë.

A do të jetë i efektshëm përdorimi i standardeve për identifikimin e performancave të dobëta në shkollë nga ana e drejtuesve? Pro janë 61.7% e pjesëmarrësve. Pa efekt e shikojnë 13.6%, të pavendosur janë 12% dhe 32.1% e shikojnë si të vështirë për të mos thënë të pamundur. Arsytet e këtyre përgjigjeve janë të lidhura dhe me arsyet e përgjigjeve të dhëna për pyetjet e mësipërme, por mendoj se më e rëndësishmja është: Amullia në të cilën ka rënë mësuesi në periudhën që jetojmë, mungesa e kontrollit të jashtëm në institucionet arsimore dhe mungesa e një organizmi kontrollues të standardeve për mësues, efekteve që jep zbatimimi i tyre në shkollë dhe evidentimi i ndryshimeve apo rregullimeve që duhen bërë në përgjithësi në punën në shkollë.

Po të shikojmë korrelacionin midis variabilit të pavarur, përdorimi i standardeve me variabilet e varur, mosha, gjinia, niveli i arsimimit, vendndodhja e shkollës vërejmë se koeficientet e korrelacionit janë të dobët në mesatar dhe treguesi “ p ” është në vlera pozitive gjë që tregon se korrelacioni ndodh për efekt të treguesve të marrë në studim dhe jo në mënyrë rastësore. Drejtuesit 100% e dinë që në institucionin e tyre përdoren standardet për mësues, mësuesit mjeshtër dhe mësuesit specialistë pothuajse në të njëjtën përqindje. 95-97% e dinë që institucioni përdor standardet për mësues. Një përqindje e vogël (5.07% dhe 3.07%) tregon indiferencën e mësuesve për këtë problem. Bie në sy përgjigjja e mësuesve të grupit, të kualifikuar në masën 100%, e justifikuar me periudhën kur ky grup i është nënshtruar provimit për të fituar pozicionin, mësues i kualifikuar e lidhur me përvetësimin e legjislacionit për mirëfunksionimin e shkollës. Bie në sy rreth 20% e mësuesve të rinj që nuk e dinë nëse shkolla ku ata kanë filluar punë punon me standardet për mësues. Ky rezultat nxjerr në pah nevojën e madhe që kanë mësuesit e rinj për t’u njohur me të gjitha hallkat dhe elementët e mirëfunksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare nëpërmjet kualifikimeve në shkollë dhe jashtë saj. Njohja dhe zbatimimi i standardeve për mësues duhet të bëhen pjesë e programeve universitarë në fakultetet e mësuesisë.

Nëse i përdorin ose jo standardet pjesëmarrësit sipas pozicionit janë përgjigjur:

Drejtuesit i përdorin 100%. Kemi një përqindje të madhe në grupet mësues mjeshtër, mësues specialist, përkatësisht 14.56% dhe 13.83% . Bie në sy rreth gjysma e mësuesve të rinj të cilët ende nuk kanë filluar të përdorin standardet në punën e tyre. Përgjegjësia bie fillimisht mbi vetë mësuesit, mbi drejtuesit për planifikim jo efektiv të kualifikimeve me këtë grup mësuesish, si dhe mbi grupin e kurrikulave dhe kualifikimeve në DAR/ZA për mungesë të vëmendjes ndaj mësuesve të rinj të sapodalë nga universitetet.

Pothuajse në të njëjtët parametra janë dhënë përgjigjet edhe për pyetjet e tjera të këtij seksioni nga ku del se; Drejtuesit informohen për ndryshimet por mungon bashkëpunimi efektiv ndërmjet mësuesve dhe drejtuesve.

Mësuesit mjeshtër dhe mësuesit specialistë duket sikur kanë pësuar ngritje në kualifikim dhe nuk interesohen shumë për ndryshimet, pra një pjesë e tyre tregon njëllëj indiference.

Më të informuarit janë mësuesit e grupit të sapo kualifikuar gjë që lidhet me kërkesat për të marrë kualifikimin, ndërmjet tyre dhe njohja e përdorimi i standardeve për mësues krahas legjislacionit dhe formimit profesional retoriko-praktik.

Mësuesit e grupit të pakualifikuar duket se janë më të painformuarit si pasojë e mungesës nga formimi universitar, për njohjen dhe përdorimin e standardeve por edhe mungesës së bashkëveprimit me mësuesit më të vjetër në shkollë. Është problem i rëndësishëm problemi i pranimit dhe i ndihmës së mësuesve të rinj nga ata më me përvojë në shkollë.

Nuk mund të lë pa përmendur thënien e drejtorit të parë me të cilin kam punuar dhe nga i cili kam mësuar shumë. *”Tre vitet e para të punës : Imponoju të tjerëve vlerat e tua dhe mos u step çfarëdo të thonë. Pyet për çdo gjë të paqartë dhe mos u fyej nga fjalët që dëgjon për “paaftësinë” tënde. Duro peshën e vërejtjeve nga drejtuesit dhe kolegët. Duro fjalët që dëgjon jashtë shkollës. Mëso prej tyre. Tregoj se sa vlen me punën tënde dhe bëj vendin tënd në shkollën ku punon.”*

Mësuesit, a janë në dijeni të rregullave të reja të kontrollit dhe vlerësimit mbështetur në standardet për mësues? Përgjigjet janë: Drejtuesit e shkollave janë në dijeni në masën 100% por ky rezultat nuk pasqyrohet në grupet e tjera në shkollë. 22% e mësuesve mjeshtër nuk janë në dijeni ose nuk e dinë që ka rregulla të reja vlerësimi. 36% e mësuesve specialist, 19% e mësuesve të kualifikuar, 43% e mësuesve të pakualifikuar nuk e dinë ose s’kanë dijeni për rregullat e reja të vlerësimit. Kjo tregon se drejtuesit e shkollave nuk kanë ndryshuar format dhe mënyrat e kontrollit të punës në shkollë, ose nuk i kanë njohur mësuesit me ndryshimet e kryera, për vlerësimin sa më të plotë të performancës së mësuesit në shkollë. Rezultatet tregojnë se procesi i zbatimit të standardeve për mësues në arsimin parauniversitar ka probleme të mëdha të cilat duhet të eliminohen sa më shpejt për të arritur ndryshimin në funksion të rritjes së cilësisë së shkollimit të nxënësve për t’iu përgjigjur zhvillimit të vrullshëm të shoqërisë.

Në kuadrin e reformimit të arsimit parauniversitar është i domosdoshëm riaktivizimi i sektorëve të inspektimit në DAR për të realizuar kontrollin e jashtëm, të domosdoshëm dhe të specializuar, të punës në të gjithë treguesit në institucionet e arsimit parauniversitar, për të shmangur rënien e mëtejshme të arsimit dhe formalitetin në punën e drejtuesve.

A ka ndryshuar performanca e drejtuesve në politikat e administrim/vlerësimit? Mësuesit përgjigjen: 29% e mësuesve mjeshtër, 41.6 % e mësuesve specialistë, 34% e mësuesve të kualifikuar dhe 47.5% e mësuesve të pakualifikuar (të rinj) nuk kanë vënë re ose nuk dinë që të ketë ndryshuar performanca e vlerësim administrimit në shkollat e tyre.

Përveç mungesës së bashkëveprimit mësues drejtues në shkollë mendoj se; problem është vështirësia e drejtuesve të vjetër për të pranuar dhe përshtatur me forma të reja efektive të punës. Mendoj se ende ka drejtues që pjesën e administrimit dhe vlerësimit e mbajnë të fshehtë, me mendimin; ta zë në gabim mësuesin dhe më pas ta ndëshkoj. Në trajnimet kualifikuese për drejtues, një nga tematikat që duhet trajtuar fort, mendoj se duhet të jetë ajo e komunikimit për të krijuar bashkëpunim dhe bashkëveprim në të gjitha hallkat e punës në shkollë si dhe përdorimi i stileve të drejtimit që rregullojnë klimën në shkollë.

A ju është thënë se në periudhën në vazhdim performanca juaj do të vlerësohet sipas standardeve të mësuesit?

Ashtu si edhe në pyetjen që trajtova më lart, edhe njëherë del në pah problematika e marrëdhënieve drejtues- drejtues, drejtues- mësues, mësues- mësues, për informimin e të gjitha grupeve dhe mbarëvajtjen e punës në institucionet e Arsimit Parauniversitar në Shqipëri.

Konkluzione/ Rekomandime

E ardhmja e arsimit në Shqipëri i takon brezave të rinj. Është detyra jonë si punonjës arsimit që t’ua shtrojmë rrugën dhe t’iu vendosim sinjalistikën e duhur për të mos u hallakatur siç jemi hallakatur në 20 vjeçarën e fundit. Për të realizuar synimin e arsimit të viteve 2020 e në vazhdim: *“që të aftësojë çdo individ të përballojë sfidat e së ardhmes; të jetë i përgjegjshëm për familjen, shoqërinë e kombin dhe në mënyrë të veçantë të zhvillojë aspektin etik, intelektual, fizik, social dhe estetik; të mendojë në mënyrë të pavarur, kritike e krijuese; t’u përshtatet ndryshimeve, të ketë vetëvlerësim e shpirt bashkëpunimi; të jetë i gatshëm të ofrojë ndihmesën e tij për mirëqenien, përparimin, lirinë e demokracinë”*. Zhvillimet në fushën e arsimit diktojnë vijimin e reformave në sistemin arsimor, si sektor jetësor i shoqërisë dhe nevojën e hartimit dhe të zbatimit të dokumenteve strategjike për t’iu përshtatur zhvillimit të shoqërisë dhe plotësimin e synimit për arsimin kombëtar shqiptar.

Studimi “Standardizimi i profesionit të mësuesit domosdoshmëri për zhvillimin cilësor të arsimit në Shqipëri“ është në sinkron me synimin kombëtar për arsimin Shqiptar.

Për t’iu dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, realizova pjesën e parë të studimit me mësues dhe drejtues shkollash në DAR/ZA Vlorë, Sarandë, Delvinë. Përfundimet janë :

Rezultati i përpjekjeve të vazhdueshme për këtë problem gjatë periudhës së gjatë të tranzicionit është vlerësimi i jashtëm dhe i brendshëm i punës së shkollës në përgjithësi dhe i mësuesit në veçanti përmes Tablosë së vlerësimit në vitin 2004 dhe krijimit të strukturave përkatëse për përdorimin e saj në MASH dhe DAR.

96.5% e pjesëmarrësve në studim i njohin standardet për mësues dhe 3.5 % nuk e dinë që përdoren standardet për mësues në shkollën ku punojnë. Treguesi 96.5% është i kënaqshëm dhe tregon se mësuesit në sistemin arsimor parauniversitar në Shqipëri janë informuar për ndryshimet në arsim. Ende është i nevojshëm kujdesi për informimin e të gjithë mësuesve për përdorimin e standardeve në punën e tyre ashtu siç informohen për ndryshimet në tekste apo programe mësimore. Drejtuesit e shkollave janë 100% të informuar për faktin se ata janë në kontakt të drejtpërdrejtë me informacionin që vjen nga MAS apo DAR/ZA. Problemi qëndron në përcjelljen e informacionit të mësuesi dhe kontrollin e zbatimit të tij.

Për një periudhë pothuajse një vjeçare është bërë punë e mirë për njohjen e standardeve nga mësuesit në shkollë *punë e cila duhet të jetë më efektive dhe më e detajuar në veprimtari të posaçme për njohjen dhe zbatimin konkret të tyre në klasë, në shkollë, në komunitet.*

Rreth 42.% e pjesëmarrësve e shikojnë me pozitivitet trajtimin e performancave të mësuesve me përdorimin e formave të reja të kontrollit në zbatim të standardeve për mësues. 13.9% e shikojnë si të pa efektshme, 31.3% e shikojnë të vështirë për të mos thënë të pamundur dhe 12.7% nuk kanë asnjë mendim. Rezultatet tregojnë punën e pamjaftueshme për njohjen dhe përdorimin e standardeve për mësues të shoqëruar me qartësimin e efekteve pozitive që ato kanë, nga ana e drejtuesve të shkollave por edhe personave përgjegjës në DAR/ZAR dhe në institucionet përgjegjëse në varësi të MAS.

Drejtuesit e shkollave e kanë të vështirë të shkëputen nga format e vjetra të kontrollit të përdorura për një kohë të gjatë jo nën efektin e përdorimit të standardeve por, ndonjëherë sipas dëshirës dhe mendimit të drejtuesit për mësuesin që vlerëson. Është i nevojshëm shoqërimi i zbatimit të standardeve në shkollë me guida të përgatitura nga specialistë të IZHA apo të DAR/ZA-ve apo drejtues dhe mësues të cilët dallohen dhe kanë krijuar përvojë positive në zbatimin e standardeve. Është gjithashtu e nevojshme sugjerimi ndaj drejtuesve të shkollave i formave dhe metodave të ndryshme të kontrollit në broshura kualifikuese, për t’ua lehtësuar punën por edhe për t’iu rritur përgjegjësinë në kryerjen e detyrës, si drejtues institucioni arsimor.

Rekomandime

Për njohjen dhe përdorimin e standardeve për mësues

- ← Nga ana e drejtuesve të shkollave të punohet nëpërmjet veprimtarive të qarta dhe të organizuara mirë për njohjen dhe sqarimin e mënyrës së përdorimit të standardeve për mësues në shkollë.
- ← Të vihen në dispozicion të mësuesve si pjesë e paketës së tyre ligjore profesionale standardet për mësues të shoqëruara me standardet lëndore sipas profilit të mësuesve nga drejtuesit e shkollës në bashkëpunim me specialistët e DAR/ZA-ve. Të konsiderohen si dokumentacion i domosdoshëm për përdorim që duhet ta ketë çdo mësues dhe drejtues.
- ← Janë të nevojshme guida me shembuj konkretë të përdorimit të standardeve sipas kompetencave që duhen përmbushur, në dispozicion të mësuesve dhe drejtuesve të insitucioneve arsimore, të përgatitura nga specialistë të IZHA, të cilët janë dhe hartuesit e standardeve.
- ← Veprimtari të kualifikuese brenda shkollës, por edhe të grupuara me rajone apo grupshkollë, duhet të jenë intensive dhe efektive, jo si shumë veprimtari kualifikuese ku mësuesit dhe drejtuesit më shpejt duan të largohen se sa të jenë të duruar dhe të motivuar.
- ← Të gjitha grupet në shkollë janë të barabarta, pavarësisht pozicionit që kanë në shkollë, si mësuesit mjeshtër edhe mësuesit e rinj të pakualifikuar, të cilët duhet të pranohen dhe ndihmohen jo me fjalë por me shembuj konkretë bashkëveprimi, për njohjen dhe zbatimin e të gjithë paketës ligjore profesionale.

- ← Të kërkohet dhe zbatohet përvoja më e mirë brenda shkollës, jashtë saj, ajo kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e përdorimit të standardeve. Sot mundësitë janë, duhet vullnet dhe dashuri për t'u bërë mësues i mirë.
- ← Drejtuesve të shkollave duhet t'iu vihen në dispozicion botime kualifikuese për përdorimin e formave dhe metodave të ndryshme të kontrollit dhe vlerësimit, për t'ua lehtësuar punën por edhe për t'iu rritur përgjegjësinë në kryerjen e detyrës.

Bibliografia

- Frabbani F. (2003)– Manuali i Pedagogjisë së përgjithshme Tr. ISP
- Vladimir Pasku (2003)– Manuali i Inspektimit Tiranë
- A. Tamo Th. Karaj E. Rapti (2005)- Mësimdhënia dhe të nxënëti Tr.
- grup autorësh (2001) – Standardet e përmbajtjes në arsimin e detyruar Tr.
- grup autorësh (2001)– Standardet e arritjes në lëndë të ndryshme të arsimit të detyruar, Tr.
- Jetmir Aliçka (1995) – Për një konceptim të ri të drejtimit të shkollës Tr MASH - Strategjia kombëtare e zhvillimit të arsimit parauniversitare në Shqipëri, Tr.2004
- F.Bezati(2002) – Vëzhgimi i specialistëve procesit mësimor, kurrikula dhe shkolla nr 3 cikli fillor, Tr SAVE THE CHILDREN(2005) – Manual vetvlerësimi i shkollës. QTKA (2005)– Profesionin e mësuesit Tr.
- Prof.as. dr. M. Gjakutaj(2005) – Standardet për mësues Tr.
- Prof.as.dr. Petrit Muka(2005) - Profesionalizmi i mësimdhënies përmes standardeve. Tr. Th.Karaj E.Rapti (1998) - Kërkimi shkencor në shkencat e edukimit Tr.
- B.Musai (2005) Mesimdhënia dhe të nxenit nderveprues Tr
- Gaston Mialaret(1995) – Pedagogjia e përgjithshme Tr.
- Aina C., (2006). Parental Background and College drop-out. Evidence from Italy. Quaderno di ricerca n. 5/2006 del dipartimento di Scienze Economiche e Metodi Quantitativi – SEMEQ dell'Università degli Studi del Piemonte Orientale “A. Avogadro”.
- Bourdieu P., Passeron, J. C. (1990). *Reproduction in Education, Society and Culture*. (2nd ed.). London: Sage.
- Crul M. (2000), *The Educational Position of the Second Generation in the Netherlands: Results, Career Routes and Explanations*, Amsterdam, EFFNATIS, IMES.
- Demetrio D., Favaro G. (2002), *Didattica interculturale. Nuovi sguardi, competenze, percorsi*. Milano, Angeli.
- Dubow E.F., Tisak J. (1989). The relation between stressful life events and adjustment in elementary school children: The role of social support and social problem-solving skills. *Child Development*, 60: 1412-1423.
- Dubow E.F., Tisak J., Causey D., Hrysko A., Reid G. (1991). A two-year longitudinal study of stressful life events, social support, end social problem-solving skills: Contributions to children's behavioral and academic adjustment. *Child Development*, 62: 583-599.
- Erikson E.H. (1968), *Identity: youth and crisis*, New York, Norton
- Francescato D., Tomai M., Ghirelli G. (2002), *Fondamenti di psicologia di comunità*, Roma, Carocci.
- Migliorini L., Piermari A., Rania N. (2008). La dispersione scolastica: analisi delle sue componenti e motivazioni. *Psicologia dell'educazione*, 2(2): 247- 262.
- Montanaro P. (2007), *Quality of Education and Human Capital: An Overview*, Banca d'Italia, discussion paper.
- Osterman K.F. (2000). Students' need for belonging in the school community. *Review of Educational Research*, 70: 323-367.
- Palmonari A. (1997), *Psicologia dell'adolescenza*, Bologna, Il Mulino
- Pombeni M. L. (1997). L'adolescente e la scuola. In: *Psicologia dell'adolescenza*. Palmonari A.(a cura di).
- Vieno A. (2005). *Creare comunità scolastica*. Unicopli, Milano.
- Vieno A., Perkins D.D., Smith T.M., Santinello M. (2005). Democratic School Climate and Sense of Community in School: A Multilevel Analysis. *American Journal of Community Psychology*, 36, 327-341.
- Vieno A., Santinello M., Pastore M., Perkins D.D. (2007). Social support, sense of community in school, and self-efficacy as resources during early adolescence: An integrative, developmentally oriented model. *American Journal of Community Psychology*, 39, 177-190.
- Zappulla C., Inguglia C., Lo Coco A. (2000). Il supporto sociale in età scolare. *Età Evolutiva*, 65: 59-69.
- Zincone G. (a cura di)(2000), *Primo rapporto sull'integrazione degli immigrati stranieri in Italia*, Il Mulino, Bologna.
- Carli R., Mosca A. (1980), *Gruppo e interazione a scuola*, Bollati Boringhieri, Torino.
- Chang L. (2004), «The role of classroom norms in contextualizing the relations of children's social behaviors to peer acceptance», *Developmental Psychology*, 40, 5, 691-702.
- Ciucci Giuliani A. (2005), *La cattedra e il banco. Costruire un relazione educativa efficace*, Carocci, Roma.
- Creemers B.P.M., Reezigt G.J. (1999), «The role of school and classroom climate in elementary school learning environments». In H.J. Freiberg (Ed.), *School climate: Measuring, improving and sustaining healthy learning environments*, Falmer Press, Philadelphia.
- Fisher L. (2003), *Sociologia della scuola*, Il Mulino, Bologna.

NDIKIMET GJUHËSORE NË GJUHËN SHQIPE SI PASOJË E ZHVILLIMEVE GLOBALISTE NË INFORMIM NË DY DEKADAT E FUNDIT

FATOS SHALA

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Drejtimi Pedagogji

ABSTRAKT

Periodha e dy dekadave të fundit karakterizohet me zhvillimin e hovshëm të mjeteve elektronike të informimit të shoqëruar me krijimin e rrjeteve të ndryshme sociale, në të cilat është arritur një shpejtësi, më parë, pothuajse e paimagjinueshme e përcjelljes dhe e këmbimit të informacioneve. Nëpërmjet rrjetit elektronik ndërkombëtar të këmbimit të informatave, të quajtur shkurtimisht Internet, sot është e mundur brenda ca sekondash të merren informacione të çfarëdo lloji nga të gjitha lëmitë e jetës, me shkrim, figurë e zë, pothuajse nga çdo cep i botës. Mirëpo, përkundër efektit pozitiv, ky zhvillim globalist marramendës i këmbimit elektronik të informatave, edhe pse i dobishëm për njerëzimin në shumë aspekte, i ka edhe anët negative. Njëra prej tyre është gjithsesi ndikimi tepër i fuqishëm dhe mjaft agresiv gjuhësor që u bëhet gjuhëve të tjera botërore nga ana e gjuhës angleze, si gjuhë në të cilën ky këmbim informatash është dominant. Termat e shumta nga gjuha angleze që përdoren në këtë formë moderne të komunikimit, tashmë po përdoren të përshtatura apo “të huazuara” nga gjuha angleze pothuajse edhe në të gjitha gjuhët e tjera, prandaj edhe i ndeshim dendur në përdorimin e përditshëm edhe në gjuhën tonë. Nga ky ndikim tepër i fuqishëm, me tendenca asimiluese, nuk janë krejtësisht immune as gjuhët më të zhvilluara të botës, prandaj edhe gjuha jonë. Vendet e ndryshme po bëjnë përpjekje të “mbrohen” nga ky ndikim agresiv “asimilues” i gjuhës angleze mbi gjuhët e tyre duke tentuar të gjejnë terma barasvlerëse për ato angleze që serviren në sasi dhe me shpejtësi jo fort lehtë të kontrollueshme. Edhe te ne bëhen përpjekje simbolike nga intelektualët e vetmuar nëpërmjet të botimit të artikujve nëpër gazeta, broshurave, e fort rrallë publikimeve më serioze në drejtim të mbrojtjes së gjuhës sonë nga ky ndikim “cenues” për të, por në aspektin institucional ende bëhet pak. Prandaj, vetëdijësimi për këtë asimilim gjuhësor bashkëkohor të ngadalshëm, me pasoja “të rrezikshme” për origjinalitetin e gjuhës sonë, në momentin aktual, shtrohet si më se i domosdoshëm.

Fjalë kyç: zhvillimet globaliste, ndikimet gjuhësore, asimilimi gjuhësor, komunikimi elektronik, internet

Hyrje

Ky punim mëton t'i vërë në pah ndikimet që i bëhen gjuhës shqipe nga gjuhët tjera, sidomos nga gjuhët me të cilat ajo është në kontakt në mjedisin bashkëkohor të komunikimit, në kuadër të zhvillimeve globaliste të mjeteve të komunikimit. Ndër këto gjuhë, në radhë të parë, hyn gjuha angleze, si gjuhë në të cilën zhvillohen kontaktet dhe përcjellja e informacioneve nëpërmjet të internetit dhe mjeteve e mënyrave tjera globaliste të komunikimit masiv, siç janë enciklopeditë dhe mjetet e informimit elektronik dhe rrjetet e ndryshme sociale, si forma në të cilat ndahen dhe përcillen informacionet në kohët e sotme.

Komunikimi me anën e mjeteve elektronike të informimit, i cili më së tepërmi zhvillohet në gjuhën angleze, megjithëse edhe në gjuhë tjera, ushtron një ndikim të madh dhe të fuqishëm gjuhësor dhe kulturor në gjuhën shqipe dhe në përdoruesit shqiptarë të këtyre mjeteve dhe formave të komunikimit masiv, të cilët, shpesh, të papërgatitur sa duhet për menynë gjuhësore-kulturore që iu ofrohet nëpërmjet tyre, i përvetësojnë termat dhe shprehjet e ndryshme nga këto gjuhë jo vetëm në trajtën origjinale por edhe në sintaksën e atyre gjuhëve, e cila ndryshon nga sintaksa e gjuhës shqipe, duke i bërë, kështu, një dëm të madh mëvetësisë dhe origjinalitetit të gjuhës sonë.

Janë pikërisht këto çështje dhe probleme gjuhësore-kulturore që synohen të vihen në pah, në një masë modeste, në këtë punim, duke synuar të jepet një kontribut sado i vogël në mbrojtjen e gjuhës sonë nga këto ndikime, guxojmë të themi, të dëmshme për qenësinë dhe origjinalitetin e saj.

Mirëpo, kjo kurrësi nuk domethënë se gjuha jonë duhet t'i refuzojë termat që huazohen nga gjuhë të tjera në rastet kur për fjalë e koncepte të caktuara nuk ekzistojnë terma përkatëse në gjuhën tonë. Por, synimi duhet të jetë që, kur ekziston mundësia, ato të jenë të përkohshme dhe të zëvendësohen sa më parë me terma burimore shqipe, dhe të mos lejohet që ato të rrinë kohë të gjatë, si parazitë, në trungun e gjuhës sonë, sepse po u rrënjosën thellë, do të jetë vështirë për t'i çrrënjësuar. Shembuj të tillë kemi nga gjuha turke dhe italiane, siç janë për shembull fjalët turke: “çerek”, “dyshek”, “dysHEME”, “zile”, apo italiane “lavaman”, “impiant”, “lavatrice”, “lavastovilje”, “peliçe”, “indietro”, e të tjera. Asnjëherë nuk është vonë për ta pastruar gjuhën amtare nga huazimet e panevojshme nga gjuhët tjera. Vetëm nevojitet përkushtimi, angazhimi dhe serioziteti i duhur nga profesionistët gjuhësorë për këto çështje, natyrisht i shoqëruar me mirëkuptimin e shoqërisë dhe të shtetit, sepse pa këto, puna e tyre nuk do t'i jepte rezultatet e duhura. Një shembull të mirë në këtë drejtim na japin gjuhëtarët kroatë të cilët kanë arritur të fusin në leksikon e gjuhës kroate mjaft fjalë burimore kroate, duke i zëvendësuar ato qoftë me ato që i kishin të ngjashme me gjuhën serbe, qoftë me të tjera nga gjuhët e huaja, siç janë ajo italiane, gjermane, e edhe angleze. Përderisa më parë letërnjoftimit i thuhej edhe në kroatishte, si në serbishte “lična karta” tani kroatët e përdorin termin “osobna iskaznica”, dhe ndërsa më parë kroatët, ashtu si edhe serbët pasaportës i thonin “pasoš” tani kroatët për këtë fjalë e përdorin termin burimor kroat “putovnica”, dhe kopjes që më parë i thuhej thjesht “kopija” në të dyja këto gjuhë, tani kroatët e përdorin termin burimor kroat “preslika”, etj. Nga këta shembuj mund të vërejmë se si me përkushtim të vendosur të gjuhëtarëve e edhe ekspertëve përkatës të fushave tjera të dijes, mund të pastrohet gjuha amtare nga barbarizmat a panevojshëm dhe të dëmshëm për integritetin dhe identitetin gjuhësor të saj.

Globalizmi gjuhësor, ndikimi dhe masat e mbrojtjes nga ai ndër popujt e ndryshëm, me theks të veçantë ndër popujt europianë

Jetojmë në një periudhë kohore e cila lirisht mund të quhet epokë e “bumit informativ”. Në këtë epokë të këtij “bumi informativ” është arritur një shpejtësi, deri para një dekade, pothuajse e paimagjinueshme e përcjelljes dhe e këmbimit të informatave, sidomos me paraqitjen e rrjetit ndërkombëtar të shpërndarjes, të dërgimit dhe të këmbimit elektronik të informatave të quajtur shkurtimisht Internet, që rrjedh nga akronimi i fjalëve international network, që nënkupton një rrjet të organizuar ndërkombëtarisht të këmbimit elektronik të informatave të të gjitha llojeve nga të gjitha lëmitë e jetës, të kulturës, shkencës dhe të artit, të pasuar së voni edhe me rrjete të ndryshme sociale, si forma të komunikimit elektronik. Nëpërmjet të këtij rrjeti elektronik ndërkombëtar të këmbimit të informatave sot është e mundur të merret vesh brenda ca sekondash se çka po ndodh në skajin më të largët të botës, si në aspektin vizual ashtu edhe në atë auditiv. Ai ka bërë, në njëfarë mënyre, që, si për ironi, gjithçka që ndodh në jetën publike të vendeve të ndryshme të jetë “transparente” madje për shembull edhe “kundër” dëshirës së pushtetmbajtësve të disa vendeve, kushtimisht të quajtura “demokratike”. Në njëfarë mënyre ky rrjet globalist elektronik ndërkombëtar i këmbimit të informatave po kontribuon shumë në “demokratizimin” e shumë vendeve jodemokratike, të cilat s’po mund më t’i fshehin me përpikëri padrejtësitë ndaj popullsisë së vet, pasi ai po e gjen mënyrën që ato t’i zbulojë dhe t’i bëjë publike. Rrjedhimisht vendet e tilla jodemokratike, nën presionin e shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, po detyrohen herët a vonë sadopak të lëshojnë pe, për t’iu ikur sanksioneve me të cilat atyre po iu kërcënohen Kombet e Bashkuara nëpërmjet të organeve të veta, po nuk hoqën dorë nga praktikatat e tilla tashmë të tejkaluara jodemokratike në pjesën më të madhe të botës, dhe rrjedhimisht, ato po fillojnë të demokratizohen. Mirëpo, përkundër efektit pozitiv, ky zhvillim globalist marramendës i këmbimit elektronik të informatave, i cili në esencë është shumë i dobishëm për njerëzimin në shumë aspekte, i ka edhe anët negative. Njëra prej tyre është gjithsesi ndikimi tepër i fuqishëm dhe mjaft agresiv gjuhësor që u bëhet gjuhëve të tjera botërore nga ana e gjuhës angleze, si gjuhë në të cilën ky këmbim informatash filloi të bëhej, pasi ai u zbulua dhe filloi të praktikohet në Amerikë së pari, në fillim për qëllime ushtarake e pastaj edhe për civile, dhe vazhdon të kryhet dhe të jetë dominant në të, për arsye edhe të faktit se gjuha angleze është gjuha më e përhapur dhe më e përdorur në botë, dhe rrjedhimisht më e përshtatshme për të komunikuar me vende që nuk e flasin gjuhën e vendit nga i cili lansohet

ndonjë informacion. Termit e shumta nga gjuha angleze që përdoren në informatikë, si: “kliko/ni”, “seleko/ni”, “ristarto/ni” dhe madje edhe “printo/ni”, në trajtën urdhërore, tashmë janë globalizuar, domethënë se përdoren në trajtën e gjuhës angleze pothuajse edhe në të gjitha gjuhët tjera, prandaj edhe i ndeshim dendur në përdorimin e përditshëm në shumë gjuhë, e edhe në gjuhën tonë. Nga ky ndikim tepër i fuqishëm, me tendenca asimiluese, nuk janë krejtësisht immune as gjuhët më të zhvilluara të botës, si: gjermanishtja, italishtja, frëngjishtja, spanjishtja, rusishtja e madje edhe kinezishtja, e të mos flasim për gjuhët e popujve numerikisht më të vegjël, ndër të cilat, mjerisht, hyn edhe gjuha e popullit tonë, pra, gjuha shqipe. Të gjitha vendet e gjuhëve të sipërpërmendura po bëjnë ç’mos që të “mbrohen” nga ky ndikim agresiv “asimilues” i gjuhës angleze mbi gjuhët e tyre duke tentuar të gjejnë terma barasvlerëse për ato angleze që servohen në sasi dhe me shpejtësi jo fort lehtë të kontrollueshme, dhe ato deri në njëfarë mase po ia dalin të arrijnë suksese që nuk mund të quhen modeste. Ndërkohë edhe te ne bëhen përpjekje simbolike nga intelektualët e vetmuar nëpërmjet të botimit të artikujve gazetareskë, broshurave, e fort rrallë publikimeve më serioze në drejtim të mbrojtjes së gjuhës sonë nga ky ndikim “rrënues” për të, por në aspektin institucional ende bëhet pak. Prandaj, vetëdijësimi për këtë “rrezik” nga asimilimi i ngadalshëm, por i sigurt, me pasoja të rrezikshme, madje, për vet ekzistencën e gjuhës sonë, në momentin aktual, shtrohet si më se i domosdoshëm. Angazhimi eventual në këtë drejtim nuk duhet të konsiderohet si prapambeturi, apo si mos ecje në “trend”, por si mbrojtje e origjinalitetit të gjuhës vetanake, në një anë, dhe e pluralitetit gjuhësor evropian, dhe, pse jo, atij botëror, nga ana tjetër, pjesë e të cilit jemi edhe ne me gjuhën tonë, pjesëtare e familjes së madhe dhe të vjetër të gjuhëve indoeuropiane. Madje edhe Kombet e Bashkuara me dispozita të veçanta të dokumenteve të veta e mbrojnë diversitetin kulturor dhe gjuhësor. Në këtë drejtim duhet cekur faktin se, duke dashur ta mbrojnë gjuhën frënge nga ndikimi i gjuhës angleze, francezët në kohën e ish-presidentit të tyre Miteran, madje nxorën një ligj të veçantë për mbrojtjen e gjuhës së tyre. Kështu, dënoheshin me gjobë pronarët e bizneseve të cilët mbishkrimet e bizneseve të tyre i kishin në anglisht e jo në frëngjisht, p.sh. me termin anglez “snack-bar” në vend të termit francez “bistreau”, etj.. Kjo gjë kontrollohej rreptësisht në çdo vend publik, dhe ata që nuk i respektonin ato dispozita ligjore për mbrojtjen e gjuhës frënge dënoheshin me gjoba të larta dhe madje edhe me burgim. Nuk do të ishte ndoshta e tepërt të përkujtohej se Franca është njëri ndër vendet themeluese të Bashkimit Evropian, dhe vend me traditë të lashtë në zhvillimin dhe praktikimin e demokracisë, që ndërmjet të tjerash kultivon barazinë ndërmjet popujve në çdo aspekt, pra edhe në atë gjuhësor, dhe autoritetet shtetërore përkatëse të saj fare nuk turpëroheshin nga ato masa, për të cilat na merr mendja se kishin të drejtë plotësisht. Sa ia kanë arritur ta mbrojnë francezët gjuhën e tyre të bukur me masa të tilla, është diçka që duhet të konstatohet, por gjithsesi përpjekjet e tyre, edhe pse në dukje të parë jodemokratike, nuk janë për të mos u vlerësuar, e assesi për t’u nënvlerësuar. Por francezët nuk janë të vetëm në këtë drejtim, pasi edhe popujt e tjerë marrin masa për ta mbrojtur gjuhën nga ndikimet e gjuhëve të tjera, dhe jo vetëm të anglishtes, megjithëse popujt, gjatë historisë edhe kanë huazuar fjalë e madje edhe shprehje nga popujt e tjerë, por sipas rregullit në masë të pranueshme që është në përputhje me parimin e ruajtjes së origjinalitetit dhe të mëvetësisë së gjuhës vetanake. Ndikimet globaliste gjuhësore në gjuhën shqipe në kohët e fundit dhe pasojat e tyre të dëmshme për qenien e saj. Po, a thua ku qëndron gjuha jonë në gjithë këtë vorbull këmbimesh e huazimesh të “imponueshme” e të “pavetëdijshme” gjuhësore. Mund të thuhet, me keqardhje, se në këtë pikëpamje, ne si popull kultivues i gjuhës sonë amtare, që duhet të jemi edhe mbrojtës i saj, e nuk jemi sa duhet, qëndrojmë në një nivel mjaft të ulët të vetëdijes kur bëhet fjalë për mbrojtjen e saj nga përdorimi, në kuadër të saj, i fjalëve të huaja, dhe nuk arrijmë dot të kuptojmë se sa dëm i bëjmë gjuhës sonë, duke huazuar pa nevojë terma e shprehje nga gjuhët e huaja, e pikë së pari nga anglishtja, pastaj nga italishtja, e dikur edhe nga serbokroatishtja edhe turqishtja.

Madje, megjithëse gjuhët, si kulturat, rrallë i mjaftojnë vetvetes, nevoja për marrëdhënie i sjell folësit e një gjuhe në kontakt të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me ata të gjuhës fqinje apo me gjuhën e folësve që kanë kulturë mbizotëruese, të habit lehtësia e pranimit të fjalëve e shprehjeve të huaja dhe zëvendësimi i fjalëve e shprehjeve shqipe me to. Kjo tendencë sidomos është e pranishme ndër të rinjtë, të cilët duke dashur të tregohen “bashkëkohorë” e në “trend” me zhvillimet kulturore e shkencore botërore, përdorin fjalë të huaja, sidomos angleze e italiane, në stilin e të ashtuquajturve “cooler”-ë, për të qenë disi më tërheqës para rrethit ku paraqiten, e shpesh i përdorin ato thjesht nga mosdija, dhe, pse jo, edhe nga paaftësia për ta gjetur termin barasvlerës përkatës shqip të nocionit të caktuar të gjuhës së huaj, nga e cila e fusin në përdorim në gjuhën tonë “të shqipëruar” atë term të huaj të huazuar. Ky trend filloi të marrë masa brengosëse sidomos pas çlirimit të vendit nga pushtuesi serb, kur, me ardhjen e administratës civile dhe ushtarake të Kombeve të Bashkuara dhe të NATO-s, dhe edhe organizatave të ndryshme të huaja qeveritare e jo-qeveritare në vendin tonë, u paraqit nevoja për numër të madh përkthyesish, dhe si pasojë e kësaj nevojë tepër të madhe për ta, iu dha rasti pothuajse çdo të riu me fond modest fjalësh qoftë në gjuhën angleze, gjermane, italiane, frënge, ose spanjishte, të angazhohej si “përkthyes” në institucionet e sipërpërmendura të administratës ndërkombëtare civile ose ushtarake të instaluar në vendin tonë, përveç, natyrisht, edhe përkthyesve të njëmendtë, të shkolluar e me përvojë dhe me shkathësi të duhura për përkthim efektiv.

Si rrjedhim i nevojës së madhe për përkthyes u ulën kriteret për pranim në këtë “profesion” relativisht dobiprurës për shumë të rinjtë. Pikërisht nga diletantizmi i këtyre “përkthyesve” “u kultivuan” shumë terma “të përkthyer” gabimisht nga ata, disa prej të cilave tashmë janë rrënjosur si të tilla në gjuhën tonë dhe të cilat madje përdoren edhe nga persona në poste shumë të larta në jetën tonë politike, e nganjëherë edhe nga disa të ashtuquajtur shkencëtarë, e të mos flasim për popullin e rëndomtë. Me ato terma i është bërë dëm i madh pastërtisë së gjuhës sonë, dhe ato do të jetë shumë vështirë të ç’rrënjosen nga përdorimi i përditshëm.

Në vijim do t’i përmendim disa prej tyre. Me ardhjen e administratës ndërkombëtare civile dhe ushtarake te ne, pas çlirimit nga okupatori serb, u paraqit nevoja për vende pune në to, dhe për të hyrë në punë qoftë në UNMIK, OSBE, KFOR,

← Nuhiu, Vesel, Ndikimet ndërgjuhësore, citim nga Sapir, Edward “Gjuha- hyrje në studimin e ligjërimin”, Rilindja, Prishtinë, 1980, f.50

ose në UNHCR e ndonjë OJQ ose OQ të huaj, duhej plotësuar formulari përkatës që paraqiste kërkesën për punësim, pra, për të hyrë në punë, në ato institucione. Duke qenë se ai formular ishte kryesisht në anglisht, e në anglisht atij i thuhet “application” (lexo: eplikejshën), shumë “përkthyes”, të angazhuar në fillim thjesht “nga rruga”, duke mos ditur ta quanin atë me emrin e duhur në gjuhën e tyre amtare i cili është “kërkesë (për punësim)”, atyre u erdhi më lehtë që termin “application” ta “shqipëronin” duke e quajtur “aplikacion”, dhe për çudi, ky term u përhap, siç ishin të përhapur edhe vetë “përkthyesit” e tillë në vendin tonë, në çdo anë të tij, dhe, për habi, tani është rrënjësor thellë në përdorim si në të shkruar ashtu edhe në të folur, dhe madje jo vetëm në trajtën e tij si emër, pra “aplikacion”, në vend se “kërkesë”, por edhe si folje “aplikoj”, në vend se “paraqes/parashtraj kërkesë”, dhe rrjedhimisht personi që e paraqiste atë kërkesë, i cili normalisht duhet të emërohej “parashtrues i kërkesës” u emërua në atë frymë “aplikant” duke u bazuar në termin anglez për atë nocion “applicant”².

Po, a thua prej nga rrjedh kjo fjalë kaq e popullarizuar së vëni te ne me trajtat e veta në formë sintagmash në stilin “A ke aplikuar?”, në vend se “A ke bërë/paraqitur kërkesë?”, pra, fjala “application”, apo siç po quhet te ne “aplikacion”? Kjo fjalë rrjedh nga fjala italiane, e ajo nga latine, “applicare” që do të thotë zbatoj, vë në jetë, dhe ajo madje, deri para çlirimit nga pushtuesi serb, edhe është përdorur në atë kuptim, edhe kur është përdorur në trajtën shqipe të saj si “aplikim”, pra në kuptimin “zbatim” dhe “aplikoj një metodë shkencore” pra “zbatoj një metodë shkencore”, “artet e aplikuar ose aplikative”, dhe megjithëse, ç’është e vërteta, ajo do të thotë edhe kërkesë, kjo, megjithatë, kurrsesi, nuk e arsyeton përdorimin e termit të huaj të “shqipëruar” “aplikacion” në vend të termit shqip “kërkesë” dhe të tjerave që rrjedhin prej tij, që u përmendën më sipër.

Më tutje, në lidhje me këtë, formulari i cili duhej të plotësohej si kërkesë për punësim apo për ndonjë konkurrim tjetër, i cili në anglisht quhet “formë”³, nga këta “përkthyes” që nuk e dinin termin shqip “formular” filloi të përdorej “i shqipëruar”, gjithnjë sipas tyre, thjesht si “formë”, dhe prandaj mund të dëgjohej e besa ende dëgjohej pyetja, apo këshilla, nga ata, “A e keni plotësuar/marrë formën zotëri/zonjë?” që shumë lehtë mund të kuptohet si “a keni hyrë në formën e duhur zotëri/zonjë?” (mbase jo për t’i sharmuar personat që i testojnë konkurruesit për ndonjë vend pune), sidomos kur dihet se ç’domethënë fjala “formë” në gjuhën tonë, pra formë ose trajtë e caktuar e ndonjë sendi, apo gjendje fizike apo psikike e caktuar e ndonjë personi. Prandaj, fjalës “formë” në anglishte duhet thënë “formular” kur e kemi fjalën për ndonjë dokument të standardizuar i cili duhet të plotësohet me të dhëna nga parashtruesi i tij në ndonjë institucion ku ai person mendon ta përdorë për qëllimin për të cilin ai dokument, i cili në shqip, pra, quhet “formular” e jo “formë”, edhe është sajuar.

Më tutje, gjatë pranisë së organizatave të ndryshme të huaja te ne, në vitet e para të pasluftës, organizoheshin aftësime të punëtorëve tanë nëpër kurse dhe seminare të ndryshme të shkurtra disa ditëshe ose disa javore, për lëmi të ndryshme profesionale, dhe ato aftësime profesionale, në gjuhën angleze quhen “trainings” e te ne filloi të përdorej termi, deri atëherë kurrë më parë i përdorur si i tillë, pra “trajnim”, edhe pse në gjuhën tonë ekziston termi “aftësim”. Përsëri ishte ky “zbulim” i të ashtuquajturve “përkthyes”, ndërsa seminarët ku mbaheshin ato aftësime ose në të cilat shqyrtoheshin çështje aktuale me rëndësi për zhvillimin e vendit tonë, të cilat në gjuhën angleze quhen “work-shop” filluan të përkthehen si “punëtori” (!?) dhe tash ky term pothuajse është bërë gjerësisht i pranuar dhe i stabilizuar.

Por, a do të duhej të ishte ashtu? Në fjalorin e gjuhës angleze për fjalën “work-shop”⁴, jepet shpjegimi punishte, punëtori, pra vend i vogël pune ku punohet, riparohet ose prodhohet diçka, ndonjë send ose mjet apo vegël, e në kuptimin e vendit dhe institucionit ku mbahet ndonjë trajtim shkencor i ndonjë çështjeje, ndoshta do të ishte më mirë të ruhej termi “seminar”, e sa i përket termit “training”⁵, na duket se terma më të përshtatshëm në gjuhën shqipe për të do të ishin: mësim, edukim, ushtrim, stërvitje, përgatitje, arsimim.

Përveç kësaj, nuk është i rrallë rasti kur për fjalën “projekt” përdoret fjala angleze “draft”⁶, si p.sh. “draft rezoluta” në vend të “projekt rezoluta”. Pastaj, në gjuhën politike ka hyrë dendur në përdorim shprehja “ne do ta suportojmë një zgjidhje të tillë...”, në vend se “ne do ta mbështesim/përkrahim një zgjidhje të tillë...”.

Me rastin e zgjedhjeve të para të lira te ne, në Kosovë, të organizuara dhe të mbikëqyrura nga OSBE-ja, ishte publikuar shpallja për to, në të cilën në një vend shkruante: “Shiko për...vendvotimin!” e përkthyer në mënyrë të fjalë për fjalëshme nga gjuha angleze: “Look for”⁷, që domethënë “Kërkoni...”, pra folja “look for” e anglishtes në shqip domethënë “Kërkoj” e jo “Shikoj për”. Pllakatet me këtë “udhëzim” të përkthyer gabimisht ishin ngjitur gjithandej në tërë vendin dhe publikoheshin pareshtur në mjetet e informimit!

Duke mos ditur si ta përkthejnë shprehjen angleze “At the end of the day” që domethënë “tek e fundit”, shumë “përkthyes” në vendin tonë e madje edhe në Shqipëri e përkthejnë në formë kalku, pra në mënyrë të fjalë për fjalëshme, “në fund të ditës”, p.sh. “At the end of the day, it does not have to say that...”, në vend se: “Tek e fundit, kjo nuk domethënë se...”, këtë shprehje e hasim të “përkthyer”: “Në fund të ditës, kjo s’domethënë se...”.

Një fjalë tjetër që është rrënjësor thellë në përdorim është gjithsesi edhe fjala “implement” dhe “implementation”⁸, që domethënë “zbatoj/plotësoj/kryej” apo edhe *jetësoj*, dhe “zbatim/plotësim/kryerje” apo *jetësim*, ndërsa te ne thjesht po përdoret, përsëri si pasojë e mosshkathësisë së “përkthyesve” tashmë të përfolur, duke qenë edhe një margaritar tjetër i tyre, si “implementoj” dhe “implementim”, pra në vend se të thuhet “zbatimi i rregullores, apo i standardeve...” përkthehet

← Çesku, Pavli, Fjalor anglisht-shqip, Edfa, Tiranë, 2000, f.44

← Çesku, Pavli, po aty, f.395

⁴ Çesku, Pavli, ibidem, f. 1454

⁵ Çesku, Pavli, ibidem, f. 1296

⁶ Çesku, Pavli, ibidem, f. 298

⁷ Çesku, Pavli, ibidem, f. 609

⁸ Çesku, Pavli, ibidem, f. 507

“implementimi i rregullores, apo i standardeve”, ose “ne po bëjmë përpjekje serioze për t’i implementuar standardet...” në vend të “ne po bëjmë përpjekje serioze për t’i zbatuar standardet”.

Rishtas bie në sy një shpallje, e cila po publikohet në gazetata tona ditore, ku po reklamohet një laptop i tipit të ri, në të cilën shkruan “Mbyllni marrëveshjen...”, e marrë drejtpërdrejt nga anglishtja “Conclude the agreement”! Por duhet ditur se në shqip fjalës angleze “agreement” i thonë edhe kontratë, dhe se kontrata ose marrëveshja nuk “mbyllet” por “lidhet”, pra në shqip thuhet “lidhni marrëveshjen/kontratën” e jo “mbyllni marrëveshjen/kontratën”! Shembuj të tillë, për fat të keq, ka mjaft, por këtë herë, do të ishim ndalur vetëm në këta që u përmendën më sipër.

Ndikimet e gjuhës italiane dhe të gjuhëve sllave në gjuhën shqipe

Por, nga ana tjetër, disi për të mos na lënë të vetmuar në këtë drejtim, edhe bashkëkombësit tanë në Shqipëri kontribuojnë, duke huazuar terma nga gjuha, për ta më e popullarizuar e huaj, ajo italiane. Megjithëse duhet të vlerësohet shkalla e njohjes së kësaj gjuhe të bukur nga ana e bashkëkombasve tanë matanë kufirit kombëtarës, prapëseprapë qëndrimi i tyre servil ndaj saj nuk mund të arsyetohet. Janë të shumta fjalët dhe shprehjet nga gjuha italiane që bashkëkombësit tanë i përdorin pa nevojë në gjuhën e tyre të folur e madje edhe të shkruar, edhe pse për to ekzistojnë fjalët dhe shprehjet shqipe.

Njëra prej këtyre fjalëve që e hasim shpesh në përdorim të bashkëkombësit tanë është fjala “impenjim” e marrë nga fjala italiane “impegno” për të shprehur termin “zotim, angazhim; premtim, zell”⁹; pastaj fjala “impiant” e marrë nga fjala italiane “impianto”¹⁰, që domethënë “montim, instalim”; pastaj shprehja “prej disa ditësh/javësh/muajsh...” e marrë nga shprehja italiane “da qualche giorno/settimane/mesi...” në vend se të thuhet “që disa ditë/javë/muaj...” Është e vërtetë se fjala italiane “da”¹¹, domethënë “nga/prej”, por në këtë rast duhet të përkthehet “që”, sepse kështu përdoret në gjuhën tonë në atë kontekst. Është vërtet e folur që ta vret veshin kur në vend të përemrit “ti” të bashkëkombësit tanë e dëgjon “ty” të përkthyer si kalk nga italishtja prej “te” që vërtet domethënë “ty”, por, në shprehjet e caktuara konkrete në shqip përdoret “ti”: p.sh. “vengo da te” përkthehet “po vij te ty” në vend se “po vij te ti”. Është e qartë se këtu ngatërrohen rasa dhanore dhe kallëzore e përemrit vetor “ti”, që e ka trajtën “ty”, në situata kur duhet të jetë e qartë se duhet të përdoret emërorja, e cila e ka trajtën “ti”. Keqpërdorime me zëvendësimin e “ti” me “ty” ka mjaft, sa faqe të tëra nuk do të mjaftonin për t’i paraqitur.

Përkundër këtyre shembujve, në Kosovë, disa fjalë kanë përdorim burimor mjaft origjinal në gjuhën amtare e që për të në Shqipëri përdoren termat ose nga italishtja ose nga frëngjishtja. E tillë është fjala burimore shqipe “ëmbëlto” e cila në Shqipëri haset e përdorur me termin italian “pastičeri”, pasticceria¹², pastaj “barnatore” për të cilën në Shqipëri përdoret më tepër fjala italiane/frënge “farmaci”, farmacia¹³. Megjithatë një term margaritar i cili përdoret në ushtrinë shqiptare, e shpresoj se nuk përdoret më, është termi sllav “zbor” për termin “tubim” i ushtarëve që bëhet para rreshtimit të mëngjesit. Ky term, në frymën e ish-socializmit realist, kishte mbetur nga kohët e bashkëpunimit ushtarak me ish-Bashkimin Sovjetik.

Ndikimet e termave islamike në gjuhën shqipe

Nuk janë të pa vërejtshme, dhe aspak më të padëmshme edhe tendencat për të futur “islamizma” në gjuhën tonë qoftë nga arabishtja apo nga turqishtja, e sidomos nga arabishtja. E tillë është për shembull përhëndetja e rëndomtë në gjuhën tonë amtare “Mirë mëngjesi/dita/ mbrëma” e cila nga pro-islamkët zëvendësohet me përhëndetjen arabe “Selam alejkum”? Pastaj “kaftjall” në vend se “mëngjes”, “inat” në vend të “mëri”, “hallall të qoftë” në vend të “Të qoftë e falur”, “ymyd” në vend të “shpresë”, “xhenet” në vend të “parajsë” “xhahnem” në vend të “ferr”, “hajvan” në vend të “kafshë/shtazë” e tjera.

Konkluzione/Rekomandime

Siç po vërehet, nga këta pak shembuj ilustrues, gjuha jonë po ngarkohet pa nevojë me fjalë e shprehje të huaja, të cilat nuk janë të parrezikshme për origjinalitetin dhe qenësinë e saj, dhe ndaj të cilave duhet të jemi të kujdesshëm që të mos i lejojmë të hyjnë në leksikon tonë, nëse për nocionet që shprehin ato i kemi barasvlerësit në gjuhën tonë. Përndryshe do të na ndodhë që gjuha jonë të pushtohet nga to dhe madje të ngulfatet prej tyre e dalëngadalë edhe të rrezikohet ekzistenca e saj. Në ruajtjen e gjuhës sonë, si tiparin më karakteristik dhe më të vlefshëm të identitetit tonë kombëtar, duhet të punojmë të gjithë dhe të jemi gjithnjë syçelë, duke e kultivuar atë, e sidomos gjuhën letrare, e kurrësi të organizojmë fushata në sulm kundër saj, sepse gjuha letrare është arritja më e madhe në bashkimin shpirtëror dhe kulturor kombëtar, i cili i paraprin edhe atij faktik. Ka edhe popuj të tjerë, madje në vetë Europë, që, si edhe ne, janë të ndarë në disa shtete, siç është kombi më i madh europian, ai gjerman, por edhe pse jetojnë në disa shtete dhe i kanë dialektet e veta, ata të gjithë, si gjermanët e Gjermanisë, si ata të Austrisë, të Zvicrës, të Lihtenshtajnit, dhe të vendeve të tjera ku jetojnë gjermanët, e kanë një gjuhë letrare, e ajo

– Leka, Ferdinand, Fjalor italisht-shqip, Infbotues, Tiranë 2007, f. 193

– Leka, Ferdinand, ibidem, f. 194

– Leka, Ferdinand, ibidem, f. 118

– Leka, Ferdinand, ibidem, f. 290

– Leka, Ferdinand, ibidem, f. 159

është “Hochdeutsch”-i i tyre, ose gjuha letrare gjermane, e cila përdoret në të gjitha mjetet e komunikimit masiv dhe në administratë në një variant. Ne si popull i vogël nuk mund t’i lejojmë vetes luks të tillë të ngrihemi kundër “padrejtësive”, siç po trumbetojnë disa kuazi-intelektualë, fatmirësisht të paktë, që gjasme na i qenkan bërë njërit dialekt në favor të dialektit tjetër, për arsye gjasme politike, kur dihet se ekspertët më të mëdhenj gjuhësorë të shqipes, nga të gjitha trojet shqiptare, kanë marrë pjesë në mënyrë të barabartë në hartimin e normës letrare duke qenë plotësisht të paanshëm ndaj ndonjërit dialekt dhe pa qenë aspak të ndikuar nga politika e kohës. Përkundrazi, angazhimi i tyre që në normën letrare të përfshihen të gjitha trajtat e të folmeve të të gjitha trojeve shqiptare në mënyrë sa më të barabartë, duhet të çmohet, e jo të vihet në dyshim dhe të nëpërkëmbet, duke u angazhuar në ruajtjen dhe kultivimin e asaj që ata me aq mund kanë arritur ta sajojnë. Natyrisht, askush nuk është kundër ekzistimit dhe ruajtjes edhe të dialekteve të veçanta të gjuhës sonë. Ato, përkundrazi, paraqesin begatinë dhe larmishmërinë e saj. Por nuk duhet lejuar që atyre t’iu jepet roli dhe rëndësia në komunikimin zyrtar e shkencor, të cilin parimisht duhet ta ketë vetëm gjuha letrare, për të gjithë shqiptarët, kudo që jetojnë. Nëse do të lejojmë që gjuha jonë të bastardohet, nga ndikimet e gjuhëve të huaja, siç po e lejojmë muzikën tonë të bastardohet, atëherë rezultati do të jetë i njëjtë si në rastin e muzikës: do të kemi edhe gjuhë “tallava”, e cila shumë lehtë mund të çojë edhe deri në shndërrimin e kombit tonë në komb “tallava”. Për t’i ikur kësaj, duhet t’ia bëjmë vetes të qartë, se a dëshirojmë që gjuha jonë të jetë gjuhë e pastër, e kultivuar, dhe e respektuar edhe nga të tjerët, apo dëshirojmë që ajo, të zbrisë në nivelin e p.sh. gjuhës rome, e cila çdo të dytën apo të tretën fjalë në leksikon e vet e ka ose serbe ose bullgare ose rumune ose turke e ku ta dijë njeriu. Për t’i ikur këtij rreziku, duhet që secili ta japë kontributin e vet në pastrimin e gjuhës amtare nga barbarizmat e panevojshëm. Një shembull i mirë është gjithësisht fillimi i zëvendësimit të disa fjalëve serbe, deri para çlirimit nga pushtuesi serb, mjaft të ngulitura në përdorimin tonë të përditshëm, siç janë p.sh. fjala “strujë” me fjalën tonë “rrymë”: si rrjedhim tani edhe të huajt kanë filluar ta përdorin shprehjen “S’ka rrymë”, dhe sinqerisht e thënë, të kënaqet zemra kur i dëgjon duke folur pastër shqip, megjithëse për diçka jo fort të këndshme, pastaj “pasaportë” ose “pasaportë” në vend të fjalës serbe “pasosh”, “certifikatë” ose “certifikatë” për ndonjërin prej “izvodave” serbe të dikurshme, e të ngjashme. Ky është një shembull se si pastrohet, me këmbëngulësi dhe me ngritje të vetëdijes, gjuha amtare nga barbarizmat. Secili duhet nisur nga vetvetja, dhe ta japë kontributin e vet modest në këtë drejtim, në familje, në shkollë, në punë, në rrugë dhe në shoqëri. Një nismë që do të duhej t’iu takonte autoriteteve arsimore në të dyja vendet do të ishte ndarja e lëndës së gjuhës dhe letërsisë shqipe në dy lëndë të veçanta, përkatësisht në gjuhën shqipe, nga njëra anë, dhe në letërsinë shqipe, nga ana tjetër, që nga fillorja. Kjo do t’i kontribuonte kultivimit të shtuar dhe të duhur të gjuhës shqipe, të shkrimit të saj dhe të shprehurit në të, duke kontribuar në shmangjen e përdorimit të termave të huaja të panevojshme në gjuhën shqipe.

Përfundim

Gjuha është tipari më dallues dhe më i vlefshëm i qenies dhe i identitetit kombëtar të një populli. Prandaj ajo duhet kultivuar dhe ruajtur me përkushtimin më të madh njerëzor, moral dhe kombëtar të çdo pjesëtari të atij kombi. Kultivimi i gjuhës amtare tregon edhe shkallën e emancipimit kulturor dhe kombëtar në përgjithësi të një populli. Ai tregon edhe shkallën e kontributit të tij në diversitetin kulturor dhe gjuhësor të bashkësisë ndërkombëtare, parim të cilin edhe vetë OKB-ja po e mbron së fundi me dispozita të veçanta në dokumentet e veta. Prandaj edhe ne si komb duhet të jemi të përkushtuar ta përmbushim këtë “standard”, vetë, pa imponim nga askush, pa na u dhënë si detyrë nga të tjerët, siç po ndodh me përmbushjen e standardeve për inkuadrime në struktura përkatëse euro-atlantike, por duke e ndier si nevojë, detyrë dhe obligim tonin të brendshëm, kombëtar, që buron nga vetë fakti se ne i takojmë kombit që e flet këtë gjuhë kaq të bukur, kaq të veçantë, sepse gjuha jonë është shenja më e vlefshme dalluese e ekzistencës dhe e lashtësisë së kombit tonë.

Nëse të gjithë angazhohemi ta mbrojmë dhe ta pastrojmë gjuhën tonë nga barbarizmat e ndryshëm të rinj dhe të vjetër, duke e ndier veten krenarë që i përkasim kombit i cili e flet njërin prej gjuhëve më të vjetra, më të bukura dhe më të veçanta të familjes së madhe të gjuhëve indoeuropiane, për këtë do të na falënderojnë brezat tanë të ardhshëm, në të kundërtën, po s’e bëjmë këtë, ata mund të na mallkojnë, por shumë lehtë mund të ndodhë, nëse tregohemi jo vigjilentë sa duhet dhe mospërfillës ndaj kultivimit dhe ruajtjes së pastërtisë së gjuhës sonë, që madje të vijmë në situatë të tillë në të cilën s’do të mund t’iu ofrojmë asnjërin prej këtyre dy mundësive.

Megjithatë, jemi plotësisht të bindur se të gjithë ne pajtohemi se në ndërgjegjen tonë do të fitojë përcaktimi për zgjidhjen e parë, dhe se ne do të arrijmë të vetëdijësohemi me kohë dhe sa e si duhet, përse i përket kësaj çështjeje me rëndësi parësore për vetë qenien e gjuhës dhe të kombit tonë.

Angazhimi jonë i tillë assesi nuk e përjashton bashkëpunimin dhe këmbimin e termave me gjuhë tjera, me të cilat gjuha jonë ka kontakt, por vetëm në rastet kur për ndonjë koncept nuk ekziston termi në gjuhën tonë, dhe mundësisht, të punohet nga gjuhëtarët dhe shkencëtarët tanë, që huazimi i tillë të jetë i përkohshëm, deri sat ë gjendet termi përkatës në gjuhën tone. Raste të tilla janë, për shembull, zëvendësimi i termave: “download” me “shkarko” nga “daunlodoj” që përdoret fillimisht, apo “update” me “përditësoj” nga “apdejtoj” që po ashtu përdoret fillimisht. Shembujt si këta të dy të sipërpërmendur duhet të jenë frymëzim për të gjithë ne, e në radhë të parë, për gjuhëtarët, që të punojnë në gjetjen e termave përkatëse shqipe, sa më parë që të jetë e mundur, për huazimet nga gjuha angleze apo ndonjë gjuhë tjetër nga e cila ato janë marrë dhe kanë hyrë si parazit të dëmshëm në gjuhën tonë. Nuk duhet të harrojmë se po nuk e mbrojmë ne gjuhën tonë nga ndikimet e gjuhëve tjera, atë nuk do ta bëjë dikush tjetër. Kjo detyrë na takon vetëm neve, sepse ajo është pasuria më e madhe kulturore që kemi, dhe shenja identifikuese e lashtësisë së popullit tonë.

Bibliografia

a) Literatura parësore

- Adamzik, Kirsten (1999) *Textsorten, Reflexionen und Analysen*, Tuebingen: Stauffenburg.
- Albrecht, Joern (1973) *Linguistik und Uebersetzung*, Tuebingen: Niemeyer (Romanistische Arbeitshefte 4)
- Albrecht, Joern (1998) *Literarische Uebersetzung, Geschichte – Theorie – Kulturelle Wirkung*. Darmstadt: Wissenschaftliche Buchgesellschaft.
- Albrecht, Joern + Gauger, Hans-Martin (2001) *Sprachvergleich und Uebersetzungsvergleich. Leistung und Grenzen, Unterschiede und Gemeinsamkeiten*. Frankfurt a. Main etc.: Lang.
- Ammann, Margret (1990 b) *Grundlagen der modernen Translationstheorie. Ein Leitfaden fur Studierende*. 2. Auflage. Heidelberg: Univ. Druckerei (th=translatorisches handeln 1).
- Ammann, Margret (1995) *Kommunikation und Kultur, Dolmetschen und Uebersetzen heute. Eine Einfuehrung fuer Studierende*. 3. Aufl. Frankfurt a. Main: Verlag fuer interkulturelle Kommunikation.
- Arntz, Reiner (1996) “*Methoden und Probleme des juristischen Uebersetzens im Sprachenpaar Italienisch-Deutsch*”, in: Der Gerichtsdolmetscher 1996.2, 17-31.
- Baker, Mona (1992), *In Other Words. A Coursebook on Translation*. London-New York: Routledge.
- Baker, Mona ed.(1992), *Routledge Encyclopedia of Translation Studies*. London-New York: Routledge.
- Basnett, Susan (1991) *Translation Studies*. Revised Edition. London/New York: Routledge.
- Basnett, Susan + Lefevere, André (1998) *Constructing Cultures. Essays on literary translation*. Clevedon-Philadelphia etc.: Multilingual Matters (Topics in translation 11).
- Basnett, Susan + Lefevere, André eds. (1990) *Translation, History and Culture*. London and New York: Pinter Publishers.
- Bell, Roger T. (1991) *Translation and Translating. Theory and Practice*. London/New York: Longman.
- Benjamin, Andrew E. (1989) *Translation and the Nature of Philosophy. A New Theory of Words*. London-New York: Routledge.
- Boerner, Wolfgang + Vogel, Klaus es. (1999) *Kontrast und Aequivalenz, Beitrage zu Sprachvergleich und Uebersetzung*. Tuebingen: Narr (Tuebingen Beitrage zur Linguistik 442)
- Brower, Reuben A. ed. (1966) *On Translation*. New York: Oxford University Press.
- Davis, Kathleen (2001) *Deconstruction and Translation*. Manchester / Northampton: St. Jerome Publishing.
- Dil, Answar D. ed. (1975) *Language Structure and Translation*. Essays by Eugene A. Nida. Stanford: Stanford University Press.
- Foucault, Michel (1999) *Die Ordnung der Dinge. Eine Archaeologie der Humanwissenschaften*. Frankfurt a. Main: Suhrkamp (suhrkamp taschenbuch wissenschaft 96).
- Friederich, Wolf (1977) *Technik des Uebersetzens. Englisch und Deutsch*. Muenchen: Hueber.
- Gallagher, John D. (1987) *Cours de traduction allemand-français. Lehrbuch mit Texten ueber Politik und Wirtschaft*. Muenchen/Wien: Oldenburg.
- Gentzler, Edwin (1993) *Contemporary Translation Theories*. London/New York: Routledge (Translation Studies).
- Gutt, Ernst August (2000) *Translation and Relevance. Cognition and Context*. 2nd edition. Oxford: St. Jerome Publishing.
- Hoenig, Hans G. + Kussmaul, Paul (1991) *Strategie der Uebersetzung*. 3. durchges. Auflage. Tuebingen; Narr (Tuebingen Beitrage zur Linguistik 205).
- Lefevre, André, (1992) *Translation: History and Culture*. London: Routledge. Nuhui,
- Vesel (1990) *Ndikimet ndërgjuhësore*, Rilindja, Redaksia e botimeve, Prishtinë
- Nuhui, Vesel (2013) *Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë
- Reiß, Katharina + Vermeer, Hans J. (1991) *Grundlegung einer allgemeinen Translationstheorie*. Tuebingen: Niemeyer, 2. Auflage (Linguistische Arbeiten 147)
- Risku, Hanna (1998) *Translatorische Kompetenz. Kognitive Grundlagen des Uebersetzens als Expertentaetigkeit*. Tuebingen: Narr (Studien zur Translation 5)
- Weinreich, Uriel (1968) *Languages in contact*, Mouton Publishers, The Hague

b) Literatura ndihmëse

- Anić Šime, Klaić Nikola, Domović Želimir, Rječnik stranih riječi, Sani-Plus, Zagreb 1999
- Aleksić, Radomir Dr., Rečnik stranih reči i izraza, Prosveta, Beograd 1978
- A. S. Hornby, An Advanced Learner's English Dictionary, Oxford University Press 1999
- Benson, Morton Dr., Englesko-Srpskohrvatski rečnik, Prosveta, Beograd 1980
- Benson, Morton Dr., Srpskohrvatsko-Engleski rečnik, Prosveta, Beograd 1980
- Česku, Pavli, Fjalor anglisht-shqip, EDFA, Tiranë 2000
- Česku, Pavli, Fjalor shqip-anglisht, EDFA, Tiranë 2000
- Group of authors, The Concise Oxford-Hachette French Dictionary, Oxford University Press & Hachette Livre 1998
- Grup autorësh, Fjalor i fjalëve të huaja, Rilindja, Prishtinë 1988
- Grup autorësh, Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Republikës së Shqipërisë, Rilindja, Prishtinë 1981
- Grup autorësh, Fjalor serbokroatisht-shqip, Instituti Albanologjik Prishtinë, Rilindja, Prishtinë 1986
- Grup autorësh, Fjalor shqip-serbokroatisht, Instituti Albanologjik Prishtinë, Rilindja, Prishtinë 1981
- Hasani, Shefije Mr., Fjalor i terminologjisë juridike: anglisht-shqip-anglisht, Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Juridik, Prishtinë 1998
- Jovanović Jasmina Mr. & Todorović Svetlana Mr., Rečnik pravnih termina Srpskohrvatsko-englesko-francuski, Savremena Administracija, Beograd 1990
- Leka Ferdinand, Fjalor italisht – shqip dhe shqip – italisht, Infbotues, Tiranë 2007
- Merriam Webster's Collegiate Dictionary, Springfield, Massachusetts 2000
- Nuhui, Vesel Dr., Fjalor shprehjesh frazeologjike anglisht-shqip, Rilindja, Prishtinë 1990
- Ragazzini Giuseppe, Biagi Adele, A Concise Italian Dictionary, Oxford-Zanichelli editore S.p.A., Bologna 1997
- Simoni Zef, Leka Ferdinand, Fjalor Italisht-Shqip, Eurorilindja, Tiranë 1996
- Simoni Zef, Leka Ferdinand, Fjalor Shqip-Italisht, Çabej-Besa, Tiranë 1996
- Vujaklija, Milan, Leksikon stranih reči i izraza, Prosveta, Beograd 1967

NDIKIMI I MEDIAS ELEKTRONIKE NË TË LEXUARIT NGA ADOLESHENTËT

FLUTURA DERVISHI

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit

ABSTRAKT

Ky studim paraqet rezultatet e një pune kërkimore, e cila synon vënien në dukje të ndikimit të medias elektronike në të lexuarit nga adoleshentët, në ditët e sotme.

Adoleshenca është moshë tranzitore e ndryshimeve të mëdha, nga varësia, te pavarësia. Është moshë e ridimensionimit të personalitetit të individit. Në formimin e personalitetit të individit në këtë moshë ndikojnë shumë faktorë, ndër të cilët është dhe leximi. Të lexuarit është një proces që të çon drejt të kërkuarit të informacionit apo si një përmbushje e kënaqësive të individit, të para këto si pjesë e spirales së suksesit të individit jo vetëm në shkollë, por edhe jashtë saj.

Zhvillimi i vrullshëm i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në vendin tonë, në vitet e fundit, është shtrirë në pothuajse në çdo sferë të jetës dhe ka prekur çdo grupmoshë. Duke patur parasysh se adoleshentët janë më të ndikueshëm përballë risive, interneti ka ndikuar në aspekte të ndryshme tek adoleshentët, një ndër të cilët është edhe qëndrimi i adoleshentëve ndaj të lexuarit. Ky studim synon të vërtetojë hipotezat se: Media elektronike ka ndikuar në uljen e lexueshmërisë nga ana e adoleshentëve; Media elektronike ka ndryshuar zakonet e të lexuarit tek adoleshentët.

Qëllimi: Të sjellim një panoramë të përgjithshme rreth ndikimit të medias elektronike tek adoleshentët, në vendin tonë, në lidhje me lexueshmërinë; të krahasojmë gjetjet individuale me përvojën e studimeve të kryera në lidhje me ndikimin e internetit në kulturën e të lexuarit tek adoleshentët. Të dhënat empirike u morën nëpërmjet metodës së anketimit dhe të fokus-grupit tek 112 nxënësit e shkollës së mesme “Vasil Kamami” në Elbasan. Nga rezultatet e hulumtimit kemi arritur në përfundimin se media elektronike ka ulur lexueshmërinë tek adoleshentët.

Fjalë kyç: *të lexuarit, adoleshentët, media elektronike, ndikim*

Hyrje

Adoleshenca është periudha moshore e kalimit nga fëmijëria, në i rritur. Përfshin një periudhë moshore nga 11 deri në 22 vjeç. Sipas psikologëve (Pettijohn, 1996; fq.95-97) ajo është një etapë e zhvillimit fizik, social, emocional, intelektual, ku i riu zhvendoset drejt të rriturit. Është moshë e ridimensionimit të personalitetit të tij. Në adoleshencë lind projekti i ri që i përket të ardhmes së afërt, jetës. Adoleshenti është i interesuar më shumë drejt zhvillimit të unit, që ka karakter intensiv (Kaza, 2006, fq.33). Faktorë të ndryshëm, qofshin ata familjarë, shoqërorë, intelektualë luajnë rol të rëndësishëm për zhvillimin e individit në këtë moshë, sa të bukur, aq edhe të brishtë.

Një nga faktorët intelektualë që luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e gjithanshëm të individit është dhe të lexuarit. Të lexuarit është aftësi jetësore bazë. Ai është gurthemeli për suksesin e fëmijës në shkollë, saqë është vështirë të përfytyrohet një aftësi tjetër që ta ilustrojë më mirë qëllimin e shkollimit (Anderson, Hiebert, Scott, Wilkinson, 1985; fq.12). Leximi është një mjet i rëndësishëm në edukimin dhe zhvillimin individual, si brenda shkollës, edhe në jetën e mëvonshme. Ai shihet si një parakusht për pjesëmarrje të suksesshme të individit në shumicën e fushave të jetës përgjatë gjithë jetës (Cullinan, 2000, fq.1; Holden, 2004, fq.18), pasi ai ndikon në zhvillimin personal në përgjithësi të individit, duke e përgatitur atë për një pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore, fetare, kulturore dhe politike, duke marrë parasysh rritjen e njohurive të përgjithshme. Duke mos pasur aftësinë për të lexuar mirë, mundësitë për realizimin e vetvetes do të jenë më të pakta. Ky ndikim i të lexuarit në jetën e secilit prej nesh i bën shumë studiues që ta quajnë leximin si një e drejtë themelore e njeriut.

Marrja e informacionit përmes të lexuarit e rrit adoleshentin, si nga ana intelektuale, ashtu edhe nga ajo emocionale. Kjo, e shprehur në mënyrën e përvetësimit të dijeve, arritjen e suksesit apo dyshimin e mosuksesit, në rritjen e vetëvlerësimit dhe vetëbesimit, në ndjenjën e kuriozitetit, në krijimin e raporteve pozitive shoqërore. Pra, përmes të lexuarit bëhet një parapërgatitje më e sigurt për jetën. Vivian Howard (2011), në studimin e tij gjeti qëndrime pozitive të adoleshentëve për të lexuarin, se si përvojat e tyre si lexues i kanë frymëzuar ata drejt të ardhmes së tyre (Howard, 2011; 50).

Shoqëria e kohëve të sotme, shoqëria e dijës, është shoqëri e ndryshimeve të mëdha, ku brezi i ri, i cili do të ketë në duar të ardhmen e këtij vendi, është përballë sfidave që shoqëria shtron. Që të jetë sa më i mirinformuar për gjithçka ndodh në botën që e rrethon, adoleshenti, i rrituri i së ardhmes, duhet të jetë koherent me informacionin, duke kërkuar e gjetur rrugët e duhura të marrjes e kuptimit të këtij informacioni. Pra, leximi kontribuon ndjeshëm në suksesin e punës, zhvillimin e karrierës dhe aftësinë për të reaguar ndaj ndryshimeve.

Zhvillimi intelektual u jep mundësi adoleshentëve të mos kufizohen vetëm në njohuritë që përvetësojnë nga programi mësimor (Dragoti, 2005; fq.40), por të jenë kërkues të informacionit edhe në botën që i rrethon, duke shfrytëzuar burime të tjera informacioni, ndër të cilët është edhe interneti. Pa pasur aftësinë e të lexuarit (qoftë të lexuarit të kuptimshëm, qoftë atij kritik), individit nuk do të arrijë ta përdorë internetin për gjetjen e informacioneve të duhura. Ndaj dhe kërkimet për të lexuarin theksojnë se të lexuarit është pjesë e rëndësishme e edukimit modern (Rosenberg, 2003), është pjesë e spirales së suksesit, fakt ky i njohur edhe më parë se adoleshentët që lexojnë për kënaqësi, gëzojnë sukses më të madh në shkollë, duke zhvilluar aftësitë e tyre të shkrimit e të leximit, përfshirë të kuptuarin e asaj që lexojnë, zhvillimin e fjalorit (Howard, 2011; 50). Larmishmëria dhe bollëku i informacionit e vë adoleshentin përballë sfidave. Ai duhet të gjejë rrugën dhe mekanizmat e duhura për të gjetur dhe përzgjedhur informacionin e duhur. Ramirez (2003, fq.10) është e mendimit se të rinjtë që kanë më shumë përvoja rreth përdorimit të pajisjeve kompjuterike dhe që rriten me këtë teknologji, mbajnë qëndrime të ndryshme ndaj leximit. Është e vërtetë që në vitet e adoleshencës nxënësit në përgjithësi nisin e seleksionojnë materialet që kanë për të lexuar si detyrim shkollor, duke lexuar gjithnjë e më pak letërsi artistike, pasojat e të cilave vërehen në lëndët e shkencave, ku, nga mungesa e të mësuarit për arsye të shprehive jo të plota dhe të duhura, ata kanë rezultatet më të ulëta (Gjokutaj, 2014;).

Problemet e të lexuarit në momentet e sotme janë bërë një çështje delikate shumë e ndjeshme, jo vetëm te fëmijët e të rinjtë, por gati e mbarë shoqërisë në të gjithë botën. Përmes një anketimi të bërë nga Nagy, Attila (2005) u arrit në përfundimin se numri i të rriturve që lexojnë një libër në vit kishte rënë në 40 për qind, krahasuar me rezultatet e gjetura më 1964, 1985 dhe 2000 (Ranjan & Singh, 2014). Studimi i Scholastic dokumentoi një rënie të lexueshmërisë duke kaluar në adoleshencë. Studimi gjeti se 48% e 6-8 vjeçarëve meshkuj ishin lexues të përditshëm, por që kjo përqindje është në rënie në 24% e 15-17 vjeçarëve. Kjo rënie vihet re edhe te femrat. Nga 45% në 28% (Scholastic, 2013, fq.28). Gjithashtu, një tjetër studim (NCES 2013) tregon të njëjtën gjë te kjo grupmoshë, një rënie nga 53% te 9 vjeçarët në 19% te 17 vjeçarët për lexuesit e përditshëm. Nga i njëjti studim rezulton një rënie e lexueshmërisë, që nga 1984, nga 81% në 76% te 9 vjeçarët, nga 70% në 53% tek 13 vjeçarët dhe nga 64% në 40% te 17 vjeçarët. Studimi gjeti se përqindja e atyre që s'lexojnë fare është rritur, duke e krahasuar me 1984-n, 8% te 13 vjeçarët dhe 9% te 17 vjeçarët, në 1984, në 22% dhe 27% në kohën e studimit(Children, Teens And Reading: A Common Sense Media Research Brief, 2014, fq.12)

Në vendin tonë ky problem ekziston në përgjithësi, por që bie në dukje sidomos te të rinjtë. Kjo edhe për faktin, se brezi i të rinjve është brezi i teknologjisë, i lindur dhe rritur në kohën e teknologjisë, ndikimet e së cilës vihen re në mënyrën e të jetuarit dhe mënyrën e të sjellurit të të rinjve. Duke u mbështetur në statistikat dhe rezultatet e nxënësve, vihet re se është zbehur dëshira e nxënësve për të lexuar. Edhe në studimin e Bankës Botërore mbi të lexuarin, u vu re se 57% e adoleshentëve janë analfabetë funksionalë, pra që paraqesin vështirësi në të kuptuarin e asaj çfarë lexojnë. Ky lloj analfabetizmi i ka rrënjët te mungesa e të lexuarit nga fëmijët dhe adoleshentët dhe cilësia a dobët e të lexuarit të tyre. Mimoza Gjokutaj shprehet se mungesa e aftësive për të realizuar një të lexuar më të kuptimshëm, të qëllimshëm dhe reflektiv, flet për cilësi të dobët të lexuari dhe, sa më shumë ngjitesh në shkallët e sistemit të edukimit (nga klasa 1-12 e më tej), vihet re se nxënësit lexojnë gjithnjë e më pak, apo gjithnjë e më pak shprehin dëshira për të lexuar. (Gjokutaj, 2014; fq.212)

Në ditët e sotme, në vendin tonë, me zhvillimin e vullshëm të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, kanë ndryshuar mjediset e leximit dhe zakonet e të lexuarit. Tashmë, bibliotekat dhe librat s'janë mjedisi dhe mjete kryesor, ku të rinjtë gjejnë informacionet e duhura. Mjafton një *IPhone* apo *SmarPhone* i thjeshtë dhe një "klik" dhe bota e informacionit është aty, pavarësisht se sa të përzgjedhura dhe të sakta janë këto informacione. Me gjithë anët pozitive që sjell kjo teknologji për njerëzimin, Birkerts (1994) argumenton se rritja e medias elektronike mund të japë ndërlkime negative për faktin se njerëzit janë më pak të angazhuar në lexim të gjerë dhe u mungon aftësia për të lexuar thellë dhe për të mbështetur një angazhim të zgjatur në lexim (Liu, 2008; 53).

Një nga faktorët që ka ndikuar në rënien e lexueshmërisë nga ana e të rinjve është zhvillimi i vullshëm i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në çdo sferë të jetës sonë, duke prekur çdo moshë. Masmmedia elektronike ka një ndikim të gjitha moshat e popullsisë, por fëmijët dhe adoleshentët janë më të ekspozuar ndaj internetit, në krahasim me më të rriturit. CopperWiki (2008) raporton se shprehitë e leximit të fëmijët janë në rënie dhe arsyet për këtë rënie janë avancimet teknologjike (sipas Loan, 2009, fq.213) Qëndrimi për një kohë të gjatë në internet dhe, kryesisht në rrjetet sociale nga të rinjtë, vjen jo vetëm si rezultat i kuriozitetit, i presionit të grupit, por edhe si rezultat i mosangazhimit në veprimtari të organizuara kulturore dhe sportive.

Interneti është kthyer në mjetin më të rëndësishëm të argëtimit nga të rinjtë. Fondacioni Kaiser (2010) raporton se adoleshentët shpenzojnë mesatarisht 2 orë në ditë duke përdorur pajisjet kompjuterike. Për shkak të zhvillimit të teknologjisë së informacionit, po ndryshojnë edhe zakonet e të lexuarit. Kress (2003) argumenton se ekrani ka zhvendosur librin. Tashmë të rinjtë kalojnë shumë kohë duke lexuar materiale në internet (Liu, 2005, fq.704), për kënaqësi apo për të plotësuar detyrimet shkollore, kryesisht kryerjen e detyrave të shtëpisë apo projekteve shkollore. E thënë ndryshe, interneti ka zhvendosur të rinjtë motivin dhe stilin e të lexuarit.

Gjithë ditën fëmija rritet nën presionin e një informacioni të shumëllojshëm që jo gjithmonë është i kontrolluar. Dhe, nën këtë presion formohen ndjenjat, emocionet, perceptimi njohës, idetë dhe vlerat e tij morale. (Dragoti, 2005; fq.91). Studime të ndryshme argumentojnë se rritja e medias elektronike ka sjellë ndikime negative, në lidhje me leximin, për faktin se njerëzit janë më pak të angazhuar për të lexuar (Liu, 2005, 704) për qëllime edukative. Por, siç shprehet Jon Dewey (2003) "Në momente kritike e kuptojmë të gjithë se e vetmja disiplinë që ne na qëndron besnike, i vetmi ushtrim që bëhet intuitiv është ai që fitohet nëpërmjet jetës. Pra, mësojmë nga përvoja, nga librat ose nga thëniet e të tjerëve, vetëm pse ato kanë lidhje me përvojën (Dewey, 2003, fq.39)".

Metodologjia

Studimi është bazuar në ndikimin e medias elektronike në ndryshimin e zakoneve të të lexuarit tek adoleshentët. Interneti, duke qenë se frekuentohet shumë nga të rinjtë, madje, është bërë pjesë e pandarë e jetës së tyre, ndikon në zhvillimin e gjithanshëm të adoleshentëve (në mënyrën e të sjellurit të tyre si brenda grupit të bashkëmoshatarëve, ashtu edhe ndaj pjesës tjetër të shoqërisë, në perceptimet e tyre ndaj gjithçkaje që i rrethon, në zakonet e tyre të jetës së përditshme etj). Interneti po ndikon mjaft në marrëdhënien e të rinjve me librin. Po vihet re se pjesa më e madhe e të rinjve vitet e fundit po i kushtojnë më shumë kohë përdorimit të internetit, sesa librit. Kjo nuk do të thotë që ata janë më të mangët në lidhje me shumëllojshmërinë e informacionit, por sa të qëndrueshme janë këto informacione të marra përmes internetit, në mënyrë jo të organizuar.

Leximi është proces i rëndësishëm në zhvillimin e gjithanshëm të individit. Falë këtij procesi, arrihet komunikimi i gjithanshëm i individit. Leximi është cilësuar si çelësi i suksesit të individit jo vetëm në shkollë, por gjatë gjithë jetës.

Ky studim synon të vërtetojë hipotezat se:

- ← Media elektronike ka ndikuar në uljen e lexueshmërisë nga ana e adoleshentëve në vendin tonë;
- ← Media elektronike ka ndryshuar zakonet e të lexuarit tek adoleshentët në vendin tonë.

Të dhënat empirike u morën nëpërmjet metodës së anketimit tek 100 nxënësit e shkollës së mesme "Vasil Kamami" në Elbasan dhe metodës së fokus grupit, të zhvilluar me 12 nxënës të tjerë krahas 100 nxënësve të përzgjedhur për anketim. Gjatë fokus-grupit u përdorën intervista gjysmë të strukturuar.

Nga rezultatet e hulumtimit kemi arritur në përfundimin se media elektronike ka ulur lexueshmërinë tek adoleshentët, si dhe ka krijuar një tjetër qasje të të rinjve ndaj leximit.

Fjalët kyçe: të lexuarit, adoleshentët, media elektronike, ndikim

Kampionimi


Numri i të anketuarve të përfshirë në këtë studim është 100 nxënës të shkollës së mesme të përgjithshme "Vasil Kamami", në Elbasan, të përzgjedhur në mënyrë rastësore. Nga këta, 58 janë femra dhe 42 meshkuj. Grupmosha e marrë në këtë studim është 16-18 vjeç. Gjithashtu, numri i pjesëmarrësve në fokus-grupe ishte 12 (2 fokus-grupe, me nga 6 nxënës). Përzgjedhja e nxënësve në fokus-grupe u bë në mënyrë rastësore, ku u përfshinë nxënës të klasave të 10-ta, 11-ta e 12-ta (nga 4 nxënës për secilën klasë). Numri i femrave dhe meshkujve ishte i barabartë. Shkolla ka 550 nxënës.

Gjetjet dhe analiza e tyre

Gjetjet përmes pyetësorëve

Koha e kaluar në internet


GRAFIKU 1



Të pyetur në lidhje me kohën e kaluar në internet, rezultoi se ata që qëndrojnë në internet deri në 1orë në ditë janë 23 të anketuar (nga këta, 15 janë femra dhe 8 meshkuj), 57 e të anketuarve janë shprehur se në internet kalojnë 2-3 orë në ditë (nga këta, 37 % janë femra dhe 20 % meshkuj) dhe 20 % prej të anketuarve janë shprehur që qëndrojnë në internet mbi 4 orë në ditë (nga këta, 8 % femra dhe 12 % meshkuj).

Faqet internetike që frekuentohen më shpesh nga adoleshentët


GRAFIKU 2



Faqet e internetit që frekuentohen më shpesh nga të anketuarit janë: Google frekuentohet nga 69 % e të anketuarve. Nga këta, 38 % femra dhe 31 % meshkuj; Facebook frekuentohet nga 78 % e të anketuarve. Nga këta, 43 % femra dhe 35 % meshkuj; Youtube frekuentohet nga 42 % e të anketuarve. Nga këta, 28 % femra dhe 14 % meshkuj. Instagrami frekuentohet nga 11 % e të anketuarve. Nga këta 6 % janë femra dhe 5 % janë meshkuj.

Koha e shpenzuar në ditë për të lexuar librat shkollorë


GRAFIKU 3



Të pyetur rreth kohës që nxënësit kalojnë duke lexuar libra shkollorë, rezultoi se ata që lexojnë 3-5 orë në ditë janë 44 % e të anketuarve. Nga këta, 32% janë femra dhe 12 % janë meshkuj. Ndërsa, ata që lexojnë rreth 2 orë në ditë janë 40 % e të anketuarve. Nga këta, 20 % janë femra dhe 20 % janë meshkuj.

Leximi i librave jashtëshkollorë


GRAFIKU 4



Të pyetur nëse lexojnë libra jashtëshkollorë, 43 % e të anketuarve u përgjigjën pozitivisht. Nga këta, 31 % janë femra dhe 12 % janë meshkuj. Negativisht u përgjigjën 57 % e të anketuarve. Nga këta, 27 % femra dhe 30 % meshkuj.

Marrja e informacionit më lehtë përmes: - librave; - revistave; - gazetave apo – internetit


GRAFIKU 5



Të pyetur se si e kanë më të lehtë ta marrin nxënësit informacionin, përmes internetit apo librave, gazetave, revistave, 75 % e të anketuarve u shprehën se e kanë më të lehtë ta marrin përmes internetit. Nga këta, 44 % janë femra dhe 31 % janë meshkuj. Ndërsa, nga 25% e të anketuarve që pohojnë si më të lehtë marrjen e informacionit përmes librave, gazetave, 14 % janë femra dhe 11 % janë meshkuj.

Ndihma e internetit në kryerjen e detyrave të shtëpisë

GRAFIKU 6



Të pyetur sa i ndihmon interneti në kryerjen e detyrave të shtëpisë në lëndë të ndryshme, rezultoi se 61% e të anketuarve pohojnë se interneti i ndihmon çdo ditë në kryerjen e detyrave të shtëpisë (nga këta, 53 % femra dhe 28 % meshkuj), 11 % pohojnë se nuk i ndihmon interneti në kryerjen e detyrave të shtëpisë (nga këta, 2% janë femra dhe 9% janë meshkuj) dhe 8% pohojnë se internetin e shfrytëzojnë ndonjëherë për detyrat e shtëpisë (nga këta, 3% femra dhe 5 % meshkuj).

Gjetjet përmes fokus- grupeve

Përmes intervistave gjysmë të strukturuar, të përdorura me fokus-grupet, nga nxënësit u morën këto pohime rreth arsyeve të përdorimit të internetit nga adoleshentët, qëndrimet e tyre rreth informacioneve të marra përmes librave dhe përmes internetit.

Arsyet për të cilat përdoret interneti nga adoleshentët:

- ← Për të kaluar kohën;
- ← Për të komunikuar me të tjerët;
- ← Për të dëgjuar muzikë;
- ← Për të postuar fotot;
- ← Për të parë video;
- ← Për të luajtur me lojëra të ndryshme;
- ← Për të marrë informacione për shkollën për detyrat e shtëpisë dhe projektet;
- ← Për të marrë informacione rreth të rejave të fundit.

Avantazhet e marrjes së informacionit përmes internetit

- ← Informacionet janë të shpejta, të larmishme, të lehta për t'u marrë;
- ← Informacioni është i përmbledhur, gati-gati i përpunuar;
- ← Kursehet koha;
- ← Me këto informacione kryen lehtë detyrat e shtëpisë.

Avantazhet e marrjes së informacionit përmes librave

- ← Informacioni përmes librave:
- ← është më i saktë, më i zgjeruar, më i kontrolluar
- ← të ndihmon të japësh interpretimin tënd;

- të ndihmon të flasësh sa më rrjedhshëm;
 - ← zhvillon imagjinatën, intuitën;
 - ← pasuron fjalorin;
 - ← të nxit të lexosh sa më shumë; Kur lexon librin:
 - ← je më i qetë nga ana psikologjike;
 - ← ndihesh më i aftë për të analizuar një temë të caktuar;
 - ← aftësohesh të përzgjedhësh atë informacion që do;
 - ← duke lexuar librin, përcillet një ndjenjë dhe emocion i veçantë, pasi botën e librit e kemi në duar.

Analiza e të dhënave

Futja e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në çdo sferë të jetës në vendin tonë i dhënë një hov të ri zhvillimit të gjithanshëm të shoqërisë shqiptare. Kjo teknologji ka prekur çdo moshë. Të rinjtë janë më të përfshirë në përdorimin e kësaj teknologjie. Gati çdo i ri disponon të paktën një aparat celulari dhe me një abonim të thjeshtë telefonik bëhet frekuentues i internetit.

Kjo teknologji e re ka ndikuar te të rinjtë, duke i dhënë, nga njëra anë, dinamikë jetës së tyre, por, nga ana tjetër, duke ndikuar edhe në të lexuarin e tyre. Nga të rriturit, është krijuar një perceptim i përbashkët se të rinjtë në ditët e sotme lexojnë gjithnjë e më pak, krahasuar me dekada më parë. Ky s'është vetëm thjesht perceptim, por edhe nga hulumtimet e kryera nga National Center for Education Statistics (2013) rezulton se leximi nga ana e të rinjve ka rënie, duke krahasuar lejueshmërinë përgjatë viteve 1984, 2004, 2012 (Children, Teens, Reading, 2014, fq.14).

Edhe në këtë studim empirik kemi arritur në të njëjtat rezultate. Le t'i analizojmë këto të dhëna.

Adoleshentët kalojnë shumë kohë në internet, krahasuar me kohën që ata kalojnë duke lexuar libra. Vihet re një përqindje dominuese e të rinjve që shpenzojnë 2-3 orë në ditë duke lundruar në faqe të ndryshme të internetit. Kjo nuk është vetëm një dukuri që po vihet re vetëm te të rinjtë shqiptarë. Fondacioni Kaiser (2010, grafiku 7) raporton se adoleshentët shpenzojnë mesatarisht 2 orë në ditë duke përdorur pajisjet kompjuterike. Ajo që bie në sy nga studimi ynë është se adoleshentët më shumë përdorin faqen e *facebook*-ut (78 % të anketuar) për të komunikuar me njëri-tjetrin dhe *gogle* (69 % të anketuar), (për të gjetur informacione për kryerjen e detyrimeve shkollore (detyrave të shtëpisë apo projekteve shkollore), ndërsa ata që lexojnë rreth 2 orë në ditë janë 40 % të anketuar. Ajo që bie në sy është luhatja në përqindje në gjini e të anketuarve, në lidhje me kohën e shpenzuar në internet dhe atë duke lexuar libra. Meshkujt shpenzojnë më shumë kohë duke qëndruar në internet, ndërsa përqindja e femrave që kalojnë mbi 3 orë duke lexuar libra është 32 % femra, nga 12 % meshkuj që e pohojnë këtë. Kjo nuk vihet re vetëm në rastin e adoleshentëve në vendin tonë. Sipas një studimi të bërë nga Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve përgjatë viteve 2000-2012, diferenca gjinore në ecurinë e të lexuarit favorizohet nga vajzat (PVNN, 2014, fq.11).

Duke analizuar grafikun 5, i ndërtuar rreth çështjes së shtruar se si e kanë më të lehtë ta marrin nxënësit informacionin, përmes internetit apo librave, gazetave apo revistave, u vu re se pjesa dominuese (75 % e të anketuarve u shprehën se e kanë më të lehtë ta marrin përmes internetit). Nga këta, 44 % janë femra dhe 31 % janë meshkuj. Ndërsa, nga 25% e të anketuarve që pohojnë si më të lehtë marrjen e informacionit përmes librave, revistave, gazetave, 14 % janë femra dhe 11 % janë meshkuj. Duke patur parasysh studimin e bërë nga Canadian Newspaper Association (2006), sipas së cilës të rinjtë shpenzojnë 3.5 orë në internet, 3.1 orë duke shikuar TV, 2.4 orë duke dëgjuar radio, 1.5 orë duke lexuar një libër, 0.7 orë duke lexuar një gazetë, 0.6 orë duke lexuar një revistë në ditë dhe të dhënat tona të gjetura përmes hulumtimit në terren, themi që të rinjtë përdorin median elektronike si rrugën më të shkurtër të marrjes së informacionit (Loan 2009, fq.214).

Duke bashkëngjitur të dhënat e marra nga anketat me të dhënat e marra përmes fokus – grupeve, arrijmë në një pikë të përbashkët se një pjesë e adoleshentëve e shfrytëzojnë faqen e informacionit në *Google* për të marrë informacion të gatshëm për të kryer lehtas detyrat e shtëpisë apo projektet. Luhatja në përqindje e të anketuarve që shprehen se interneti i ndihmon në kryerjen e detyrave të shtëpisë me ata që shprehin të kundërtën e saj është e madhe 61% me 8%. Detyrat e shtëpisë jepen për të matur te nxënësit përvetësimin e lendes së re të marrë në klasë, konkretizimin e këtyre njohurive përmes ushtrimeve a kërkesave të ndryshme, si një urë lidhëse përmes shkollës e familjes. Duke i marrë të gatshme përgjigjet e detyrave të shtëpisë nga nxënësit, zbehet rëndësia e tyre. Vërtet interneti i ndihmon nxënësit për të marrë informacione shtesë, krahas informacionit të marrë në klasë, qoftë për detyrat e shtëpisë, qoftë për projektet, duke zhvilluar te nxënësit aftësinë e kërkuesit shkencor, por kurrësi të shërbejë për ta marrë informacionin e gatshëm pa e analizuar atë. Kështu humbet qëllimi arsimor i lundrimit në internet nga nxënësit.

Leximet jashtëshkollore apo të njohura ndryshe si leximi për kënaqësi janë baza e të lexuarit përgjatë gjithë jetës, pasi, duke lexuar libra jashtë detyrimit shkollor, fëmija, adoleshenti është i lirë në përzgjedhjen e literaturës që do të lexojë. Kur këta fëmijë ose të rinj lihen të lirë në përzgjedhjen e tyre, ata janë më të angazhuar në përmblidhjen me sukses të qëllimeve që i vënë vetes, pasi, përmes lirshmërisë në përzgjedhje, ata rrisin vetëbesimin dhe vetëvlerësimin e tyre. Kjo ndodh në çdo hap që fëmijët dhe sidomos adoleshentët hedhin në jetë. Kjo duhet parë edhe për të lexuarin për kënaqësi. Duke u krijuar kjo lirshmëri përzgjedhjeje, nxiten motivet e brendshme për të përzgjedhur tematika, autorë, përmes të cilëve adoleshenti gjen veten, krahasohet me ta, përipiqet të ecë në rrugën e tyre.

Leximi për kënaqësi, që plotësohet më së miri përmes librave jashtëshkollorë, duket sikur është lënë pas dore te të anketuarit tanë, pasi përqindja e të anketuarve që shprehen se nuk lexojnë libra jashtëshkollorë është më e madhe (57 %), krahasuar me ata që lexojnë (43 %). Zbehja e dëshirës për të lexuar libra jashtëshkollorë në kohën e lirë dominon te meshkujt, kjo edhe për

faktin se përqindja e meshkujve që kalojnë shumë kohë në internet është më e lartë se e femrave. Psh. Nga të dhënat e nxjerra gjatë hulumtimit dhe të paraqitura në grafikun 1, del se 8 % e femrave dhe 12 % e meshkujve rrinë në internet më shumë se 4 orë në ditë, duke llogaritur që numri i të anketuarve meshkuj ishte më i vogël se i femrave. Nga njëra anë, të qëndruarit gjatë në rrjetet sociale dhe, nga ana tjetër, fakti që sipas një numër studimesh tregojnë se djemtë lexojnë më pak se vajzat (Clark dhe Foster, 2005, fq.3) bën që kjo kategori lexuesish të largohen nga libri.

Nga hulumtimi i kryer përmes fokus –grupeve del se të rinjtë e kalojnë kohën duke lundruar në rrjetet sociale, kryesisht për t'u argëtuar dhe për të marrë informacione për shkollën dhe detyrat e shtëpisë. Pra, leximi, qoftë edhe përmes internetit, sot për sot tek adoleshentët s' shfrytëzohet për qëllime arsimore e edukative. Pra, ky zakon i krijuar rreth të lexuarit, i bën të rinjtë pasive, duke u mjaftuar me informacione të gatshme. Kjo nënkupton që të lexuarit nga pjesa më e madhe të këta të rinj s' shihet si i qëllimshëm, por vetëm si një detyrim i përbushjes së detyrave shkollore, siç shprehen edhe ata vetë “informacionet përmes internetit janë të lehta për t'u marrë, janë të gatshme dhe me to kryhen lehtë detyrat e shtëpisë”, duke vlerësuar edhe elementin kohë për gjetjen e informacionit të kërkuar.

Me gjithë këtë zbehje të dëshirës të një pjesë e të rinjve për t'u marrë me leximin, duke e parë këtë të fundit thjesht si detyrim shkollor, përsëri themi se interneti vetëm sa ka krijuar një qasje tjetër të gjetjes, të përzgjedhjes së informacionit, duke mos mbetur vetëm te libri i printuar. Përmes fokus-grupit, vërejmë se një pjesë e mirë e adoleshentëve e vlerësojnë librin e printuar për rëndësinë që ky ka në zhvillimin e gjithanshëm të lexuesit. Ndikimin pozitiv të leximit në aspektin intelektual e shohim përmes shprehjeve të tyre rreth avantazheve të leximit të librave se “informacioni përmes librave është më i saktë, më i zgjeruar, më i kontrolluar; të zhvillon imagjinatën, intuitën; të pasuron fjalorin; të nxit të lexosh sa më shumë”, në zhvillimin psikologjik “je më i qetë nga ana psikologjike; duke lexuar librin, përcillet një ndjenjë dhe emocion i veçantë, pasi botën e librit e kemi në duar” apo zhvillimin social “të ndihmon të japësh interpretimin tënd; të ndihmon të flasësh sa më rrjedhshëm dhe ndihesh më i aftë për të analizuar një temë të caktuar”. Të njëjtat gjetje vijnë përmes studimit të Vivian Howard (2011). Në studimin e tij gjeti qëndrime pozitive të adoleshentëve për të lexuarin, se si përvojat e tyre si lexues i kanë frymëzuar ata drejt të ardhmes së tyre (Howard, 2011).

Përfundime

Nga rezultatet e këtij studimi empirik u konstatua se media elektronike ka ulur lexueshmërinë tek adoleshentët, si dhe ka krijuar një tjetër qasje të të rinjve ndaj leximit. Konkretisht:

- ← Interneti zë pjesën më të madhe të kohës nga adoleshentët;
- ← Internetin, pjesa më e madhe e adoleshentëve e përdorin kryesisht për t'u argëtuar (duke përdorur *facebook*-un, *youtub*-in, *instagram*-in) dhe për të përbushur lehtas kryerjen e detyrave të shtëpisë apo projektet; -adoleshentët shpenzojnë më shumë nga koha e tyre në internet, sesa duke lexuar librat shkollorë (nga 3 orë e lart -77 nxënës, krahasuar me 44 nxënës)
- ← adoleshentët mbajnë qëndrime të ndryshme rreth marrjes së informacionit përmes leximit të librave dhe përmes internetit;

Kjo vërteton hipotezat e ngritura në fillim të këtij hulumtimi se:

- ← Media elektronike ka ndikuar në uljen e lexueshmërisë nga ana e adoleshentëve në vendin tonë;
- ← Media elektronike ka ndryshuar zakonet e të lexuarit tek adoleshentët në vendin tonë.

Bibliografia

- Cilësia e Arsimit dhe Mundësitë për Zhvillimin e Aftësive në Shqipëri, 2014 <http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Albania/al-pisa-report-al.pdf>
- Clark, Ch dhe Foster, A, 2005; Children's and Young People's Reading Habits and Preferences The who, what, why, where and when Cole, L. C. (1994). The concise dictionary of quotations
- Cullian, B; Independent Reading and School Achievement, Volume 3,
- 2000 Deëey, J, Shkolla dhe shoqëria, Tiranë, 2003 Dragoti, E, Adolshenti, Tiranë, 2005
- Eye-track III. (2006). Recall of information presented in text vs. multimedia format Gjokutaj, M, Didaktika e gjuhës shipe, Tiranë, 2014
- Holden, J (2004), Creative Reading - Young people, reading and public libraries
- Hopper, R. (2005). What are teenagers reading? Adolescent fiction reading habits and reading choices. Literacy, 39(3) 113-120. Howard, V (2011); The importance of pleasure reading in the lives of young teens ; Journal of Librarianship and Information Science 43(1) at <http://lis.sagepub.com/content/43/1/46>
- Loan, F, Impact of New Technology on Reading Habits: A Glimpse on the World Literature; 2009 (Paper presented in national seminar Role of School Libraries in Quality Education organised by Division of Library, Documentation and Information (DLDI), NCERT,

- Kaiser Family Foundation, *Generation M2: Media in the lives of 8- to 18- Years- Olds*, 2010
- Kaza, N; *adoleshenca, stina e shpërthimeve*; Tiranë, 2006
- Kirsch, I.S., & Guthrie, J.T. (1984). Adult reading practices for work and leisure. *Adult Education Quarterly*, 34, 213-232.
- Liu, Z. (2008), *Paper to Digital – Documents in the Information Age*, Printed in the United States of America, 2008
- Loan, F, *Impact of New Technology on Reading Habits: A Glimpse on the World Literature* in core.ac.uk:8081/download/pdf/16292463.pdf
- Mokotsi, R. (2005). *Sharing resources- how library networks can help reach education Goals*. East African Book Development Association. A research paper looking at libraries in the developing world. Commission by Book Aid International
- Moore, D. W., Bean, T. W., Birdyshaw, D., & Rycik, J. A. (1999). *Adolescent literacy: A position statement*. International Reading Association, 1-19.
- Moyes, J. (2000). *Idea that Net is killing book reading can be filed under fiction*. The Independent, May 18 May 2000 <http://www.independent.co.uk/arts-entertainment/books/news/idea-that-net-is-killing-book-reading-can-be-filed-under-fiction-718166.html>
- Nagy, A. (2007). *Reading and value system: trends in the changes of book reading*.
- National Center for Education Statistics. (2013). *The Nation's Report Card: Trends in Academic Progress 2012* (NCES 2013-456). National Center for Education Statistics, Institute of Education Sciences, U.S. Department of Education, Washington, D.C. <http://nces.ed.gov/nationsreportcard/>.
- Scholastic. (2013). *Kids and Family Reading Report: 4th Edition*
- Ramirez, E; *The Impact of the Internet on the Reading Practices of a University Community: The case of UNAM* <http://webdoc.sub.gwdg.de/ebook/aw/2003/ifla/vortraege/iv/ifla69/papers/019e-Ramirez.pdf>
- Ranjan & Singh, *International Trends in Library and Information Technology*. Vol.1, No.2, 2014, fq.46
- Rideout, V. J., Foehr, U. G., & Roberts, D. F. (2010). *Generation M2: Media in the lives of 8 to 18 year olds*. Palo Alto: The Kaiser Foundation.
- Ruterana, P (2012; fq.10); *The making of a reading society*
- The Hindu (2004) *Whither the reading habit?* Online India National Neëspaper

THE ROLE OF PARENT-CHILD INTERACTION IN LANGUAGE ACQUISITION AND PERSONALITY DEVELOPMENT OF YOUNG CHILDREN IN MONOLINGUAL AND BILINGUAL FAMILIES

MEHMET ASLAN

“Hëna e Plotë” Beder University

ABSTRAKT

Our differences throughout history led us to different methodologies in complying with educational rules as in our today's world there has been a great diversity of methodological approaches to education in different schools or institutions which stems from cultural, regional, political and personality differences. Together with globalization and development of technology the standards in education started to be based on materialistic issues in terms of facilities like labs, sports centers, smart boards, and even swimming pools. A parent in search of a school for his/her child is first to look above mentioned modern standards. Spiritual, moral values are started to be less important for parents and their children. As one of the two primary objectives, this article aims to bring these issues to the surface as they came to be obstacles in front of our children's developments as well as some educational issues, like truancy, lack of morality, parents' misguiding etc. As to gain a global perspective to the personality development of children, the role of parents together with teachers or instructors is also one of the important issues to be held in this article.

As a second, more particular issue, approaches to the development of young children, parents' interactions and language development suggest some important elements of personality development in early childhood. Language is considered to be first step of a child's personality development as it shapes his/her character and temperament together with cognitive development. In this article as the second primary objective, it is aimed to get into depths of language development in monolingual and bilingual families and the children's acquisition of language in terms of speed, quality, comprehension, adaptation, and ability of learning two or more languages at the same time.

Key Words: *Personality development, language acquisition, monolingual and bilingual families.*

Introduction

As the study is mainly based on development of children in terms of language and personality; teacher's role is essential in all parts of child's life. Nonetheless, parents are also teachers who are to be considered volunteers and pioneers of education. Teachers have an undeniable role in inculcating moral values among students. Students' moral values are taken from various sources; family, friends, work place, observed events, reading, thinking and experiences introduce many moral values that keep us at different operative and intentional levels. We should conceptualize education as a whole, having to do directly with all approaches and methodologies. Teacher's role either in class or off the class cannot merely be restrained to an instructor who teaches what is in the curriculum; teachers also have many other roles as sometimes they are second parents to students, some other times, therapists, psychologists, and more importantly role models for students. It is one of teacher's duties towards education to try to make students achieve the best they can, and when that requires teaching them the moral values of the society they live in, then that's what a good teacher should do as part of student's personality development and language acquisition to a wider extent.

The most essential factor in language development, however, is parental guidance through which a child may acquire two or more languages and have more developed cognitive skills. Children need to have the opportunity to solve problems and discover the world around them. On the other hand, after age five learning capacity of children is not the same as early infant ages; their inborn, internal ability gradually declines, and after age five the biggest opportunity of learning more than one language is not of that much advantageous. *There is strong evidence that children may never acquire a language if they have not been exposed to a language before they reach the age of 6 or 7. Children between the ages of 2 and 6 acquire language so rapidly that by 6 they are competent language users* (Clark, 2000). There is, however, much more variation in how well and how quickly individuals acquire a second language. Nevertheless, scant studies on the issue don't provide concrete evidence that there are biological restrictions for second language learning or that children have discovered advantages over adults. *"It is in children's use of exploratory language - the language of wondering, their inquiring, their conjecturing, their considering, their imagining - that we are occasionally able to glimpse through windows into our children's thought."* (Lindfors, 1991, pp. 8, 9).

This study together with scant literature suggests that the more words babies hear, the faster they learn to talk. One of the surprising hypotheses suggested in this study is that bilingual family settings for learners are flexible and may acquire two languages in the time in which monolinguals acquire one. As related to personality development, teachers would find it easier to teach moral values and have bilingual students adapt the societal expectations in this regard. It is also observed that educational problems such as truancy, drug usage, drop outs etc. are less seen among bilingual students in relation to their healthy parent-child interactions since infancy. However, this study as a first step to further empirical studies is mainly based on literature review and observations.

Language development

Language development is also a biological process through which stems some other cognitive and corporal skills. We human beings, unlike animals, learn everything from the beginning which made psychologists and scientists focus on learning skills. There are some steps that every child takes to gain language development. These steps as commonly accepted are as follow:

- ← Physical and Motor Development (walking, hand movement)
- ← Cognitive Development (imitation, memory, categorization)
- ← Emotional Development (Positive Emotions, Negative Emotions)
- ← Social and Language Development
- ← Family and Society

Language is inextricably entwined with our mental life. Our perceiving, our remembering, our attending, our comprehending, our thinking. In short, all of our attempts to make sense of our experience in the world... (Lindfors, 1991, p. 8)

All languages – no matter where or how they are used (spoken, signed, or written) – share important properties that distinguish them from other kinds of communication systems. Young children and babies are able to recognize differences between sound patterns of any language. Infants hear their mother's voices before birth and know the rhythm of their mother language as newborns. When the baby is born, he/she is equipped with ability of discriminating the sounds of all languages. *Although there are many differences in parent-child interaction patterns around the world, virtually all normally developing children become language users at the same rate* (Clark, 2000). Blocks of language or sound patterns are known as phonemes which different studies show as babies being more familiar with than adults. A child's language constantly develops and changes. Adults are not as active as children in language communication as it is one of the basic needs for babies to be heard and to hear.

Parents Interactions in Language Development

In the average child, at whatever developmental stage we observe, language is alive and well. Children's language development is a creative process that only needs a rich environment to thrive (Lindfors, 1991). The rich environment is mostly provided by parents who are also part of the environment that helps child's language acquisition.

“The essential features of the environment that influence children’s development are their relationships with the important people in their lives – beginning with their parents and other family members, and extending outward to include child care providers, teachers, and coaches – within the places to which they are exposed – from playgrounds to libraries to schools to soccer leagues.” (National Scientific Council on the Developing Child, 2004, p. 4).”

An important thing to be noted here is that child’s understanding of the language develops through parents instructional interactions which helps child to speak later on. Understanding the language happens faster than and before the ability of speaking. For example, if a mother tells her infant child to put the toys back in the toy chest, he may follow her instructions even though he can’t say what she said. A collaboration of caregiving by father and mother helps in development of the language, while guiding, responding the needs of the child and playing they create a kind of bond that help attachment and language development. Vygotsky (1986) put forward as a basis of argument that social interactions with adults within the cultural settings of society are of central importance to cognitive development. Building on Vygotsky’s theories, Rogoff (1990) put forward the idea that skill development involves the interaction of two parties, a teacher (an adult) and a learner (a child). She called this an *“apprenticeship-type relationship”* that required *“guided participation”* happening during daily experiences. As mother is the main caregiver she is considered as the most essential asset with her role of language development. The process of language development is also with modifications of the learned and self-correction in which parents’ role is vital to gain needed skills, accommodation and adaptation of new settings and situations. The process is also full of modifications as speaking itself requires changes in verbal symbols as a languages are mobile not stable.

Language Development in Monolingual and Bilingual Families

There are a number of practice skills identified and used in training staff. *These skills in relationship-based early intervention included the capacity to: 1) listen carefully; 2) demonstrate concern and empathy; 3) promote reflection; 4) observe and highlight the parent/child relationship; 5) respect role boundaries; 6) respond thoughtfully in emotionally intense interactions; and 7) understand, regulate, and use one’s own feelings (Gilkerson & Taylor Ritzler, in press)*. These skills apply to relationships on a number of different levels, both with bilingual and monolingual families. The speed of the language development doesn’t depend on teaching one or two languages at the same time, it mostly rely on parents’ effective interaction with their kid(s);

“How often and how well parents communicate with their children is a strong predictor of how rapidly children expand their language learning. Encouraging children to express their needs, ideas, and feelings whether in one language or two enriches children linguistically and cognitively. Engaging the children and encouraging them to express themselves interactively while building on their prior knowledge in real-life situations is an effective way to build language experience (Cuevas, 1996; McLaughlin, 1984).”

Monolingual Families

As we know that different cultures expose their infants to language in various ways, nonetheless, the outcome is almost the same as in acquiring the first language. Fluency in their first language happens to almost all children around the world.

In other words, in an average family, child’s language acquisition may not be considered a success, but rather part of child’s biological development as it is not considered to be something extra than normal biological development. The most important thing is parents’ interactive relation that results into contribution of child’s cognitive development. The question is do children in monolingual families acquire the language faster than the ones in bilingual families;

“Virtually every child develops linguistic and communicative competence, and it is learned naturally and in context, not arranged in an easy-to-difficult sequence. The fact that both children and adults constantly communicate with a high degree of success is evidence that we are all following the same rules for appropriate communication behavior (Lindfors, 1991; McLaughlin, 1984).

As to rephrase, our language development is a process of following the same rules that decide on the speed of acquisition which suggests that the number of languages being learned doesn’t affect the speed of acquisition in an average family. Which brings up the idea of positive effects of teaching more than one language as it would help the child to cope with difficulties in a more enhanced way.

Bilingual Families

Most children in the world learn to speak two languages. Bilingualism is present in just about every country around the world, in all classes of society, and in all age groups (Grosjean, 1982; McLaughlin, 1984).

Surprisingly, although children raised in bilingual environments have to learn roughly twice as much about language as their monolingual peers, the speed of acquisition is comparable in monolinguals and bilinguals.

“There are no negative effects for children who are bilingual. Their language development follows the same pattern as that of monolingual children (Goodz, 1994). Children who develop proficiency in using their native language to communicate, to gain information, to solve problems, and to think can easily learn to use a second language in similar ways (Pérez & Torres-Guzmán, 1996, p. 96). Even young children who are learning a second language bring all of the knowledge about language learning they have acquired through developing their first language. For these children, then, second-language acquisition is not a process of discovering what language is, but rather of discovering what this language is (Tabors, 1997, p. 12).”

Language development before age five is quite crucial as all senses are open and children are ready to acquire all the information given in that regard, thus it's quite vital to make the best out of this period and to organize a setting together with parents' interactions with children in where children can obtain two or even more languages at the same time.

Although there have been negative approaches to bilingualism in terms of personality and identity development (Appel and Muysken, 1987), recent studies on bilingualism have brought biased evidence on the side of bilingualism claiming that it affects not only personality but also cognitive development of children; among them is McLaughlin, B. (Ed.). (2013), for example, arguing that it is not bilingualism but poor or weak societal settings that causes problems in children's personality development. The advantages of bilingualism have been excavated by many newly conducted studies claiming not only on personality but also on cognitive, intelligence, educational development etc. (Bialystok, 2001; Bialystok, Craik, Klein, and Viswanathan, 2004; Bialystok, Craik and Ryan, 2006; Martin-rhee & Bialystok, 2008; Bialystok, 2011).

Educational Problems and Personality Development

We as parents or teachers try to emphasize the importance of effort regardless its result while teaching children, even if they make mistakes or come up with unacceptable results. On the other hand, real life does vice versa as rewards are given to those who achieve success accepted by social norms, thus unmerited flattery may avoid revealing of true talents of children. At this point it is important to develop a healthy relationship between adults (parent or teacher) and children. *"All learning takes place in the context of relationships and is critically affected by the quality of those relationships"* (Norman-Murch, 1996). Thus, one of the main problems has been lying under misjudging or not realizing the true capabilities/talents of our children. The problems in education are kind of endless, here are just some subheadings:

Truancy

Truancy, as a collaborative misleading of parent-child interaction causes a great deal of gap in children's development as students, with parents' permission in many cases, stay away from school for quite a long time throughout the year. Sometimes parents even take their children on vacation at school time without being charged in any way as the rules are not conveying such problems. The main problem behind truancy is that students don't spend enough time at school and eventually fall back in many topics. *"Truancy is also a strong predictor of juvenile problems, including delinquent activity, social isolation, gang involvement, educational failure, substance abuse, delinquency, teen pregnancy, and school dropout"* (as cited in Trujillo, L. A. 2006).

Use of drugs

As a worldwide problem use of drugs has been one of the major problems facing children and the schools as institutions. The crucial relationships as the main principle in helping child progress for young aged children mental health, language development, personality development in at risk families in terms of drug usage, has been topic of research for many years. Recently, the focus by many researchers is mostly given to intervention at early ages as to prevent misconducts significantly to those who are lacking in development both linguistically and mentally. (Kalmanson & Seligman, 1992; Weston et al, 1997; Greenspan et al, 1998; Miller & Hanft, 1998; McCollum et al, 2001; Wilcox & Weber, 2001; Pilkington & Malinowski, 2002; Gilkerson & Taylor Ritzler, in press). On the other hand, children are still able to reach drugs, alcohol and tobacco products more easily. These substances are available everywhere and sold in legal or illegal ways. Governmental controls don't seem to be enough. Children can start these addictions by having been affected from their close friends. The consumption of these substances messes not only their bodies but also their spiritual worlds. There is a positive correlation between the usage of addiction and committing crime. The much consumption of drugs and alcohol cause the more criminal incidents. A child who commits the first crime becomes more likely to commit the subsequent crimes.

Internet

Following statistics taken from internet live statistics are worth to mention;

"Around 40% of the world population has an internet connection today. In 1995, it was less than 1%. The number of internet users has increased tenfold from 1999 to 2013. The first billion was reached in 200, the second billion in 2010, and the third billion in 2014." (2015, April 20). Internet is an effective tool to reach information if it is used in this way. When the children access the internet, they are under the exposure of every kind of information. The access of sexual oriented web sites, gambling web sites are very easy. To prevent it, secure internet packages or protective programs must be supplied besides giving reasonable explanations to the child. Also social network creates another challenge for the parents. In the case of Facebook usage, personal pictures and information can be misused easily and be abused illegally. Chatting sites cause them to find imaginary friends and to create an unreal world that changes the child's character in an undesired way. As mentioned earlier if schools can provide effective role models for students, they can be fostered in more benign settings with more qualified personnel, in other words, teachers as being role models for students they can prevent such misconducts of internet and instead they can improve students' personalities, educational sides by having them attended extracurricular activities or courses for learning the internet for better usage and purposes.

Conclusion

Moral values are of the essential elements in education. Morality refers to doing the right thing (behavior) for the right reason. Why are we honest, for example? Is it only because of altruistic feelings or because we see the rewards (benefits) of being honest (including the benefit of getting a good feeling)? That makes it a benefit-oriented morality. Are we honest because we fear the consequences of being dishonest? That makes it a fear-oriented morality.

If we are going to have a better society for today and the future, it is absolutely necessary to teach our kids moral values in school. One of the best ways to do this is to expose our children at the earliest age in school to positive role models in our society. Such a channel is first to test the qualities and side effects of role models, and then propose approaches that can find the intersection points for both teachers and students as to provide role models for students. As such positive role models are rarely found in families and societies, it is much more necessary for schools to involve moral values within their curriculums and provide representatives of role models as to complete the missing link between students and societies of their model citizens. Furthermore, *“the public holds schools and teacher more accountable for student learning, as demonstrated by everyone’s expectations for stronger student performances on standardized tests and higher graduation rates”* (Lumpkin, A. 2008). In today’s world when everything is valued with material measurements, we need people who can be models of the moral values, in other words, representatives of commitment, devotion, sacrifice etc. teachers with good qualities who are willing to drop tears for others’ smiles. They should have these values, patience, enthusiasm, knowledge of the subject, good listeners, kind, fair, ability of stimulating students and such.

The practice of education starts within the family, thus, this article is mostly based on a more particular issue of parent-child interaction in terms of gaining language development as it’s the first step of child’s personality development. Infancy and early childhood is the ideal time to let in your child in a foreign language. Babies gain understanding much before they can speak and benefit from having a rich language setting. It is because babies learn to talk by listening. This article together with recent studies suggest that the more words babies hear, the faster they learn to talk. The more often babies are exposed to daily language practices as well as social engagement in active interactions, the better cognitive skills are perceived in regard with language acquisition. One of the surprising facts suggested in our research is that bilingual learners are flexible and may acquire two languages in the time in which monolinguals acquire one.

References

- Appel, R., & Muysken, P. (1987). *Bilingualism and language contact*. London: Edward Arnold, 18.
- Bialystok, E., Craik, F. I., Klein, R., & Viswanathan, M. (2004). Bilingualism, aging, and cognitive control: evidence from the Simon task. *Psychology and aging*, 19(2), 290.
- Bialystok, E., Craik, F. I., & Ryan, J. (2006). Executive control in a modified antisaccade task: Effects of aging and bilingualism. *Journal of Experimental Psychology: Learning, Memory, and Cognition*, 32(6), 1341.
- Bialystok, Ellen. “Reshaping the mind: the benefits of bilingualism.” *Canadian Journal of Experimental Psychology/Revue canadienne de psychologie expérimentale* 65.4 (2011): 229.
- Clark, Beverly A. “First-and Second-Language Acquisition in Early Childhood.” (2000).
- Craik, F., & Bialystok, E. (2005). Intelligence and executive control: Evidence from aging and bilingualism. *Cortex*, 41(2), 222-224.
- Gilkinson, L. & Taylor Ritzler, T. (in press). The role of reflective process in infusing Relationship-based practice into an early intervention system. In Finello, K.M. (Editor). *The handbook of training and practice in infant and preschool mental health* (January 2005). Jossey-Bass.
- Goodz, N. S. (1994). Interactions between parents and children in bilingual families. In F. Genesee (Ed.), *Educating second language children: The whole child, the whole curriculum, the whole community*. Cambridge, England: Cambridge University Press. (ERIC Document No. ED375641)
- Greenspan, S., Weider, S., & Simons, R. (1998). *The child with special needs: Encouraging intellectual and emotional growth*. Reading, Massachusetts: Perseus Books.
- Grosjean, F. (1982). *Life with two languages*. Cambridge, MA: Harvard University Press.
- Internetlivestats, (2015). Retrieved from: <http://www.internetlivestats.com/internet-users/>.
- Kalmanson, B., & Seligman, S. (1992). Family-provider relationships: The basis of all interventions. *Inf Young Children*, 4(4): 46-52.
- Lindfors, J. W. (1991). *Children’s language and learning* (2nd Ed.). Boston: Allyn and Bacon.
- Lumpkin, A. (2008). Teachers as role models teaching character and moral virtues. *Journal of Physical Education, Recreation & Dance*, 79(2), 45-50.
- Martin-Rhee, M. M., & Bialystok, E. (2008). The development of two types of inhibitory control in monolingual and bilingual children. *Bilingualism: language and cognition*, 11(01), 81-93.
- McCollum, J.A., Gooler, F.G., Appl, D.J., & Yates, T.J. (2001). PIWI: enhancing parent-child interaction as a foundation for early intervention. *Inf Young Children*, 14 (1): 34-45.
- McLaughlin, B. (1984). *Second language acquisition in childhood: Vol. 1. Preschool children* (2nd ed.). Hillsdale, NJ: Erlbaum. (ERIC Document No. ED154604)
- McLaughlin, B. (Ed.). (2013). *Second language acquisition in childhood: Volume 2: School-age Children*. Psychology Press.
- Miller, J.L. & Hanft, B.E. (1998). Building positive alliances: Partnerships with families as the cornerstone of developmental assessment. *Inf Young Children*, 11 (1): 49-60.
- National Scientific Council on the Developing Child. (2004). *Young children develop in an environment of relationships*. Waltham, Mass; Heller School for Social Policy and Management at Brandeis University.

- Norman-Murch, (1996). Reflective supervision as a vehicle for individual and organizational development. *ZERO TO THREE*, October/November 1996.
- Pérez, B., & Torres-Guzmán, M. (1996). *Learning in two worlds* (2nd ed.). New York: Longman.
- Pilkington, K. and Malinowski, M (2002). The natural environment II: Uncovering deeper responsibilities within relationship-based services. *Inf Young Children* 2002; 15(2): 78-84.
- Rogoff, B. (1990). *Apprenticeship in thinking: Cognitive development in social context*. Oxford University Press.
- Tabors, P. (1997). *One child, two languages*. Baltimore, MD: Paul H. Brookes. (ERIC Document No. ED405987).
- Trujillo, L. A. (2006). School truancy: A case study of a successful truancy reduction model in the public schools. *UC Davis Journal of Juvenile Law and Policy*, 10, 69-95.
- Vygotsky, L. S. (1986). *Thought and language* (rev. ed.).
- Weston, D. Ivins, B. Heffron, M. & Sweet, N. (1997). Formulating the centrality of relationships in early intervention: An organizational perspective. *Inf Young Children*, (9)3, 1-12.
- Wilcox, M.J. & Weber, C.A. (2001). Relationship-based practice in early intervention. Washington, D.C.; Poster presentation at the NAEYC National Institute for Early Childhood Professional Development.

ECURIA DHE PUNA E VLERËSIMIT TË MËSIMDHËNËSVE DHE MBIJETESA E GJUHËS SHQIPE NË TRANZICION

AFËRDITA NIMANI

Universiteti, European i Tiranës Fakulteti: Shkencat sociale, Profili: Pedagogji.

Autorja është Doktorante në Profilin: Pedagogji, në Universitetin European të Tiranës (UET), është profesoreshë e "Gjuhës shqipe dhe letërsisë," si dhe Ligjëruese e "Shkrim akademik" në Kolegjin "Biznesi" Gjakovë, Kosovë

ABSTRAKT

Gjatë të kaluarës së shkollës shqipe, vlerësimi i mësimdhënësve ka qenë pjesë përbërëse, i cili si proces, varësisht nga periudhat nëpër të cilin ka kaluar shkolla shqipe në Kosovë, kur janë përcaktuar edhe qëllimet e politikës arsimore të institucioneve shtetërorë. Në vitet e fundit në arsimin parauniversitar të Kosovës, në synimet e përgjithshme të institucioneve të Kosovës, përveç përpjekjeve për të ndërtuar një legjislacion të avancuar dhe cilësor të infrastruktures, gjithëpërfshirëse të nxënësve dhe të teknologjisë. Korniza e kurrikulës, në Strategjinë për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë (2007-2017), mes të cilës i është dhënë hapësirë e duhur, cilësi dhe efektivitet, për arsimin parauniversitar. Në këto dokumente të rëndësishme arsimore po bëhen përpjekje, që të shkëputemi nga sistemi i kaluar arsimor. Mbijetesa e shkollës shqipe nën okupimin serb të viteve 90-të dhe fazës së pasluftës së tranzicionit, ishte periudhë e mbijetesës se vetë Gjuhës shqipe. Padyshim, gjendja emergjente e pasluftës kërkonte procese intensive dhe transformuese për të arritur synimin e veprimeve të ardhshme reformuese nëpër të cilën fazë është duke kaluar arsimit parauniversitar në Kosovë.

Në këtë proces vlerësimi dhe aftësimi i mësimdhënësve është paraqitur si domosdoshmëri për ngritjen e cilësisë në arsimin parauniversitar. Në arsimin parauniversitar në Kosovë, institucionet arsimore kanë vërejtur me kohë se reforma kurrikulare, aftësimet e mësimdhënësve në forma dhe programe të ndryshme, tekstet e reja shkollore dhe qasjet në vlerësimin e jashtëm të nxënësve përmes testeve shtetërore kanë dhënë tregues se ky proces po ndryshon, për të mirë!

Fjalë kyç: *Arsimi, Tranzicioni, Reforma, Ndryshimet, Vlerësimi, Mësimdhënësi, Kurrikula, suksesi, Gjuha shqipe.*

Hyrje

Në kuadrin e ngritjes të kapaciteteve të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, formimin e drejtorive rajonale dhe angazhimi i tyre i drejtpërdrejtë në mbikëqyrjen e procesit arsimor kishte mangësi disa vjet në vlerësimin e jashtëm të mësimdhënësve. Ky problem që nga paslufta nuk ishte trajtuar drejt dhe me kohë. Përvojat e arsimit parauniversitar, kur është çështja e vlerësimit të mësimdhënësve, performancës së tyre në mësimdhënie ka një traditë në Kosovë. Në rrethana politike të zhvillimit të arsimit parauniversitar në Kosovë kanë ekzistuar forma të vlerësimit të mësimdhënësve që nga fundi i viteve 60-ta, deri në vitet e 90-ta, kuptohet në kushte të tjera politike, të cilat shpesh janë drejtuar edhe nga interesat politike të asaj kohë. Kjo veprimtari është zhvilluar në kuadrin e Enteve Pedagogjike Rajonale. Në rrethanat e sotme, mësimdhënësit e arsimit parauniversitar ndodhen para zbatimit të planit strategjik të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Vlerësimin e Performancës së Mësimdhënësve (VPM), plan strategjik, Procedurat dhe kriteret e VPM-së, që përmban kritere, standarde, procedura dhe mjete për vlerësim. Si plan strategjik ka kaluar fazën e pilotimit në 10 shkolla parauniversitare të Kosovës gjatë vitit shkollor 2010-2011. Pas këtij viti janë bërë vlerësime dhe janë ngritur departamente të veçanta si në Ministri ashtu edhe në Drejtori rajonale. Reforma e arsimit në hapësirën evropiane kanë pasur reflektim të fuqishëm në shumë shtete. Kështu, edhe arsimit pas luftës së fundit në Kosovë, pas një periudhe të mbijetesës nga okupimi serb, është duke bërë përpjekje që të jetë pjesë aktive e hapësirës evropiane të arsimit. Një nga aspektet e kësaj veprimtarie, që edhe sot e kësaj dite është një sfidë e arsimit parauniversitar në Kosovë, është reforma në arsimin të nivelit parauniversitar. Ndryshimet e domosdoshme duke e harmonizuar atë me standardet e vlerësimeve evropiane, në kompleksitetin e së cilës është sidomos mbijetesja e Gjuhës dhe letërsisë shqipe. Në këtë kontekst, arsimit fillor dhe ai i mesëm si dhe shkollat profesionale, janë duke kaluar në periudhën e shkëputjes nga konceptimi tradicional i mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ku pritet të vendosen kriteret të avancimit për të vlerësuar, për të matur arritshmërinë e nxënësve gjatë procesit të të nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme që aftësitë e tyre të përkohshme me shkrimin dhe komunikimin e Gjuhës shqipe. Krahas respektimit dhe angazhimit të Ministrisë së Arsimit, drejtorive komunale, Enteve pedagogjike, drejtorëve të shkollave, kanë bërë ndryshime dhe kjo aftësi teorike dhe praktike, ka reflektuar në të gjithë vendin në arsimin parauniversitar të Kosovës. Mirëpo, jemi të vetëdijshëm se mbetet shumë për t'u bërë në shkëputjen nga strukturime dhe përmbajtja tradicionale e mësimdhënies. Padyshim, kërkohen ndryshime edhe në hartimin e përmbajtjes së planprogramet nga mësimdhënësit, avancimi i procedimeve dhe përcaktimeve në vlerësimin e tyre, tejkalimi i mënyrave tradicionale në mësimdhënie dhe avancimi i mësimdhënësve përmes seminareve, projekteve, diskutimeve dhe vjeljes së përvojave të përparura nga hapësira evropiane e arsimit parauniversitar.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Studimi i vlerësimit profesional të performancës së mësimdhënësve që pritet të zbatohet nga viti shkollor: 2013-2014, në arsimin parauniversitar në Kosovë do të hap shumë çështje duke filluar:

- ← Çfarë ka rezultuar në analizën e pilotimit të këtij plani strategjik, mangësitë dhe përparësitë në vlerësimin e performancës të mësimdhënësve.
- ← Përcaktimi i kapaciteteve ekzistuese në kuadrin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, në departament të veçantë dhe personal që do të realizojnë këtë veprimtari në funksion të inspektorëve.
- ← Përgatitja profesionale e inspektorëve duke u aftësuar në trajnime të veçanta, se sa do ta realizojnë këtë veprimtari në vlerësim të performancës së mësimdhënësve të Gjuhës shqipe.
- ← Në vlerësimin e brendshëm të mësimdhënësve në institucionet parauniversitare duhet bërë nga drejtoret e shkollave fillore dhe të mesme të Kosovës. Ecuria do të jetë kompetence profesionale e personelit të autorizuar brenda shkollës që duhet të zbatojë këtë kërkesë të planit Strategjik të Ministrisë.
- ← Cilat situata në procesin e mësimdhënies do të jenë primare në vëzhgim dhe vlerësim si: të jashtëm, nga inspektorët e arsimit, ashtu edhe në vlerësimin e brendshëm nga drejtorët dhe stafit menaxhues i shkollës.
- ← Studimi ka të bëjë me periudhën e pilotimit dhe hulumtimin e shqetësimit të mësimdhënësve, se kemi të bëjmë me karrierën e tyre profesionale dhe licencimin.

Gjatë studimit të këtij problem jemi të vetëdijshëm që do të hapen edhe çështje tjera që duhet vëzhguar, hulumtuar dhe analizuar me kujdes.

Sistemi individual i vlerësimit të mësimdhënësve që do të fillojë të zbatohet në arsimin parauniversitar (2014) do të plotësojë mjaft mirë një mekanizëm dhe do të krijoj vlerësim të jashtëm qendror të sigurimit të cilësisë, „Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve (KSHLM). Si pjesë e planit zhvillimor të shkollës, shkollat duhet të zhvillojnë dhe të implementojnë një sistem për verifikim të brendshëm të vlerësimit, me role të përcaktuara dhe personale të kualifikuar. Verifikimi i vlerësimit të brendshëm duhet të udhëhiqet nga shërbimet profesionale që janë brenda stafit të shkollës, si dhe të përfshihen edhe aktivet profesionale nga të gjitha lëndët mësimore, ku dhe nxirret një raport mbi cilësinë e vlerësimit për secilin

← KSHLM, MASHT, Standardet dhe kriteret për Vlerësimin e Performancës së Mësimdhënësve, Gusht 2012, draft.

← Inspektoriati Kombëtar I Arsimit Parauniversitar, Standardet e zhvillimit profesional për inspektorin, Tiranë 2010

← Udhëzimi Administrativ nr.5/2010, date 27.04.2010, Liçencimi I mësimdhënësve, MASHT, Prishtinë

mësimdhënës. Ndërsa mënyra e veprimit në vlerësimin e jashtëm të mësimdhënësve të arsimit parauniversitar pretendohet të zhvillohet, së paku deri në fazën kur vlerësimi individual i mësimdhënësve bëhet i panevojshëm, ashtu përkufizohet edhe në përvojat e shteteve tjera, të cilat kanë filluar që më parë këtë veprimtari. Duke u nisur nga ky aspekt, në këtë studim duhet t'i referohemi të gjitha dokumenteve të MASHT-it. Kjo e bën vlerësimin e performancës një proces kompleks që duhet të jetë sa më i strukturuar, por i nënshtrohet gjithnjë ndryshimeve që të jetë me të arriturat e mësimdhënies së avancuar si dhe qëllimeve në politikat e arsimit të Kosovës. Padyshim, kërkesë imediate është edhe referimi i përvojave të vlerësimit të performancës në Shqipëri, në shtetet tjera të rajonit si dhe në përvojat e hapësirës arsimore evropiane. Gjatë studimit të këtij punimi do t'i referohemi, së pari vlerësimit të mësimdhënësve të arsimit parauniversitar në të kaluarën duke filluar nga vitet 60-ta, deri në vitet 90-ta, të shekullit të kaluar. Sipas dokumentacionin legjislativ të asaj kohe, në rrethana tej politike me të cilën përballlej sistemi arsimor po dhe ai individual i vlerësimit të mësimdhënësve. Kur i marrim parasysh zhvillimet e shumta që kërkojnë aftësim të mësimdhënësve dhe cilësi ishte e pamundur të bëhet një vlerësim cilësor dhe efektiv në të kaluarën, ngase strukturat e asaj kohe ishin të tilla. «Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në Republikën e Kosovës ka kaluar nëpër një dekadë të ristrukturimit intensiv që ka synuar avancimin e cilësisë së mësimdhënësve të të nxëniet në kompensimin e humbjeve të një dekade të punës në rrethana jashtëzakonisht të rënda gjatë viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar. Sfidë më e madhe do të jetë ofrimi i aftësimi dhe vlerësimit cilësor të mësimdhënësve, të hartuara sipas nevojave të mësimdhënësve, i orientuar kah përkrahjes e zbatimit të reformave, dhe i qëndrueshëm (përfshirë edhe qëndrueshmërinë financiare). Aftësimi i mësimdhënësve duhet tu përshtatet ndryshimeve në kurrikulat dhe në teknologjinë e përpëruar. Cilësia e arsimit për të arritur një rezultat pozitiv varet nga shumë faktor, megjithë atë aftësimi dhe certifikimi i mësimdhënësve mbetet faktori më i rëndësishëm dhe sfidë kyçe për përmirësimin e cilësisë dhe vlerësimin në tërësi. Reformat janë ndërmarrë si në përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit, ashtu edhe gjatë aftësimi pa shkëputje nga puna, që filluan të zbatohen në arsimin parauniversitar në vitin (2014), do të plotësojë mjaft mirë një mekanizëm dhe do të krijojë vlerësim të jashtëm qendror të sigurimit të cilësisë nga, Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve (KSHLM). Sistemi i licencimit është i lidhur ngushtë edhe me sistemin e pagave. Në këtë kuptim, Këshilli Shtetëror për Licencimin e mësimdhënësve (KSHLM), është themeluar për të hartuar politikat dhe për të mbikëqyrur procesin e licencimit të mësimdhënësve, ndërsa aktualisht përpjekjet janë përqendruar në zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Kjo mënyrë e veprimit ka të bëjë edhe me vlerësimin e jashtëm të mësimdhënësve të arsimit parauniversitar pretendohet të zhvillohet, së paku deri në fazën kur vlerësimi individual i mësimdhënësve bëhet i panevojshëm ashtu si përkufizohet edhe në përvojat e shteteve të tjera, të cilat kanë filluar që më parë këtë veprimtari. Kjo e bën vlerësimin e performancës një proces kompleks që duhet të jetë sa më i strukturuar, por i nënshtrohet gjithnjë ndryshimeve për të arriturat e mësimdhënies së avancuar si dhe qëllimeve në politikat e arsimit të Kosovës. Padyshim, kërkesë imediate është edhe referimi i përvojave të vlerësimit të performancës në Shqipëri, në shtetet e tjera të rajonit si dhe në përvojat e hapësirës arsimore evropiane. Në duhet të mendojmë, së pari për vazhdimin e krijimit të një sistemi efikas dhe cilësorë në arsimin parauniversitar të Kosovës. Pas luftës së fundit në Kosovë, në fazën e tranzicionit, krahas institucioneve vendore një ndihmë e drejtpërdrejtë ka qenë edhe nga Bashkësia Ndërkombëtare, në forma të ndryshme, duke u nisur nga: kurset e financuara, trajnime të aftësimi të mësimdhënësve, ngritjen e Qendrave Didaktike, projekte të ndryshme të MASHT-it, ku edhe sot e kësaj dite vazhdojnë me trajnime të ndryshme. Kurrikula Bërthamë që ka përfshirë shkollat 10 shkolla pilot të nivelit parauniversitar të Kosovës, duke filluar nga klasat e para të arsimit fillor, nga klasat e gjashta të arsimit të mesëm të ulët dhe nga klasat e dhjeta në arsimin e mesëm të lartë, si dhe shkollat profesionale, ku priten rezultate të mira. Qëllimi i kësaj tek Gjuha dhe komunikimi është: zhvillimi i shkathtësive themelore gjuhësore, të kuptuarit përmes dëgjimit, të lexuarit lexim-kuptim, të kuptuarit e teksteve të shkruara, të shkruarit e teksteve letrare dhe jo letrare, njohja e sistemit gjuhësor, formimi i përgjithshëm gjuhësor, letrar, kulturor dhe jetësor etj.

Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Në vlerësimin e performancës së mësimdhënësve, në vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm është e domosdoshme të realizohet nga persona të autorizuar (inspektorët e arsimit, drejtorët e shkollave ose ekspertë të angazhuar nga arsimit i lartë) që kanë kompetenca profesionale të përafërta ose që i takojnë njëres nga fushat e parapara sipas Kornizës së Kurrikulumit. Gjatë pilotimit të vlerësimit të performancës në 10 shkolla të arsimit parauniversitar në Kosovë, ekipet e inspektorëve të arsimit janë përballuar me shumë sfida dhe vlerësimet e tyre nuk kanë rezultuar aq sa duhet në përmbushjen e efekteve të parashikuara. Kurrikulat bërthamë përmbajnë gjithë strukturën e arsimit para fillor, arsimit fillor, arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë. Përmbajtjet përbrenda përkufizojnë në detaje veçoritë e arsimit të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar, kompetencat e të nxëniet, shkallët e kurrikulës, rezultatet e të nxëniet, fushat e kurrikulës, planet mësimore, mësimi me zgjedhje, udhëzimet (metodologjitë), për organizimin e procesit mësimor. Vlerësimi dhe sukcesi i nxënësve dhe aspektet e tjera lidhur me zbatimin e këtyre rregullave të sjellin sukseste. Këto dokumente, besoj se përmbushin të gjitha kërkesat e shoqërisë për secilin në nivel formal të arsimit parauniversitar. Kështu krijohen mundësi të reja që të zhvillohen tek nxënësit dijet, dhe tek mësimdhënësit vlerësimi, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat duke kultivuar identitetin personal, kombëtar, të përkatësisë shtetërore e kulturore, duke promovuar vlerat e përgjithshme kulturore dhe qytetare. Duke zhvilluar përgjegjësitë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit, si dhe duke aftësuar për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore

– Plani Strategjiki i Arsimit në Kosovë 2011-2016

– Udhëzuesi, Standardet e vlerësimit, Nr. 490/01 B, 23.12.2011

e kulturore, duke zhvilluar për përdorimin e teknologjisë, si proces për të mësuarit gjatë gjithë jetës. Mësimdhënësi përdor metoda mësimore bashkëkohore ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse dhe forma të shumëllojshme të punës dhe një kompleks të tërë procedurash (informacion i ri, përforsim, ushtrim, punë me projekte, etj). Këto metoda duhet të jenë në funksion të nxitjes së mendimit të pavarur, kritik e krijues. Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënies të së cilës lëndë. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve tan. Metodatat dhe teknikat e punës mësimore dhe zbatimit më të shpejt dhe më të saktë të njohurive, shkathtësive, vlerësimit, qëndrimeve dhe vlerave të tjera, që marrin pjesë në tërësinë e formimit të personalitetit të tyre formues. Me përkushtim profesional është mundësuar zbatueshmëria e Kurrikulave Bërthamë në koherencë dhe rezultuar aq sa duhet në përbushjen e efekteve të parashikuara. Kështu gjatë formulimit të kësaj hipoteze janë hapur edhe çështje të tjera, supozime që: në arsimin fillor mund të arrihet një efektivitet më i madh në vlerësimin e performancës së mësimdhënësve, sepse kjo veprimtari mund të realizohet nga inspektorët me kompetenca profesionale pedagogjike, në arsimin e mesëm të ulët vlerësimin e performancës së mësimdhënies mund ta realizojmë mes kompetencave profesionale, inspektorë të arsimit që kanë kualifikime sipas fushave të Kornizës Kurrikulare, në arsimin e mesëm të drejtimeve të përgjithshme, sidomos në gjimnaze dhe shkolla profesionale, vlerësimin e performancës së mësimdhënies mund të realizojnë vetëm me kompetenca profesionale të profilit të njëjtë. Ndërsa në shkollat e mesme profesionale, vlerësimin e mësimdhënësve, në mungesë të kuadrit të inspektorëve të profileve përkatëse është e domosdoshme të angazhohen specialistë dhe ekspertë të arsimit të lartë të fushave gjuhësore. Në të kundërtën, a mund të vlerësojë me profesionalizëm gjitha fushëveprimet sipas mjetorit të vëzhgimit të orës mësimore, të përgatitjes së mësimdhënësve dhe organizimit të punës praktike? A është gjithë përfshirës mjetori që ka të bëjë me vlerësimin e performancës së mësimdhënies? Ky mjetor (formular për vëzhgim) është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë, janë rradhitur një varg pyetjesh që kanë lidhshmëri me treguesit e veçantë që rrjedhin nga Korniza. Në pjesën e dytë, janë dhënë vetëm dy pyetje të hapura, të cilat u mundësojnë që të mësimdhënësit të shprehin vlerësimin e përgjithshëm lidhur me performancën e tyre.⁷ Kërkimi ka për qëllim që të identifikojë dhe argumentoj të gjitha sfidat me të cilën përballen inspektorët e arsimit, drejtorët e shkollave gjatë procesit të vlerësimit. Ky studim nuk do të ishte i plotë nëse nuk kërkojmë edhe informacione kthyes, sidomos nga mësimdhënësit, të cilët i janë nënshtruar vlerësimit të performancës së mësimdhënies gjatë pilotimit. Disa nga pyetjet kërkimore mund të jenë:

- ← për inspektorët e arsimit
- ← duke pasur parasysh shkallën e shkollimit dhe profilin e profesionit përshkruani shkallën e vështërsisë (1-5) që jeni përballur gjatë vlerësimit të performancës së mësimdhënies të mësimdhënësit.
- ← Sa keni qenë korrekt dhe keni bërë një vlerësim të drejtë të mësimdhënësve, të cilët nuk janë koherent me kompetencat e juaja profesionale?
- ← A janë të mjaftueshme njohuritë e juaja të përgjithshme të mësimdhënies për të bërë një vlerësim korrekt të performancës së mësimdhënësve?
- ← Në zbatimin e njohurive në situata të reja, inspektorët e arsimit dhe drejtorët sfidohen sidomos në shkollat profesionale. A jeni dakord me këtë konstatim dhe si keni vepruar ose do të veproni në situata të tilla?

Gjatë vlerësimit, ju lutem të keni parasysh që është e pritshme që vlerësimi juaj a do të ndryshojë në aspektet e ndryshme të cilat vlerësohen, pasi që është e zakonshme që mësimdhënësit nuk do të kenë performancë të nivelit të njëjtë në të gjitha aspektet e përfshira në performancën e tyre. A është kategorizuar drejt vlerësimi në Performacë të shkëlqyeshme, Performacë të mirë, Performacë të mjaftueshme dhe Performacë jo të mjaftueshme? Çfarë kishit mënjanuar ose shtuar këtyre kategorive: Kurrikula Bërthamë mundëson hartimin e planeve dhe programeve me bazë në shkollë, teksteve mësimore dhe burimeve tjera si dhe shumë dokumenteve të tjerë që e lehtësojnë mësimdhënien dhe mësimnxënien të bazuar në kompetenca. Në këtë hap të rëndësishëm dhe reflektues të reformave sistemi arsimor po kompletohet dhe po demonstron, përkushtimi për finalizimin e projektit tonë për arsimin evropian e me njohje ndërkombëtare. Rëndësia Kurrikulës Bërthamë: Kurrikula bërthamë është dokument që do zbatohet në shkollat e Kosovës.⁸ Kornizën e Kurrikulës së Kosovës është miratuar nga MASHT në gusht të vitit 2011. Me këtë dokument përcaktohen rezultatet e kompetencave për lëmi të ndryshme të jetës të shprehura në njohuri faktike dhe procedurale, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që duhet të zhvillohen të nxënësit gjatë periudhave të caktuara kohore si dhe qasjet, metodologjitë e zbatueshmërisë, monitorimi dhe vlerësimi. Gjithashtu ky dokument përcakton shpërndarjen kohore për fushat e kurrikulës dhe ndërlidhjen në mes tyre të cilat mundësojnë progres në zhvillimin e kompetencave tek nxënësit, në zhvillimin gradual, në zhvillimin e kompetencave për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe në integrimin e lehtë shoqëror duke i përgatitur që të përballen me sfidat e jetës. Nivelet formale të arsimit parauniversitar të Kosovës përputhen me sistemin ndërkombëtar të klasifikimit të arsimit (SNKA) të përpiluar nga UNESCO, dallueshmëri ka në përbërjen e strukturës Kurrikulës Bërthamë. Të gjitha nivelet formale të arsimit parauniversitar janë të ndara në nivele formale me emërtim- Shkollat e kurrikulës, që kanë qëllime të caktuara dhe janë në funksion të emërtimeve të secilit prej tyre. Këtu përcaktohet pritja e suksesit, pra duke marrë në rishqyrtim përvojat e hapësirës evropiane të arsimit, çështjet teorike e shkencore, por edhe vlerat e arritura në përvojat praktike të organizimit të të gjitha lëndëve mësimore e në veçanti të Gjuhës dhe letërsisë shqipe në arsimin parauniversitar në hapësirën shqiptare. Bazuar në Kornizën e Kurrikulës, fusha Gjuhë dhe

← MASHT, Korniza e Kurrikulës së Kosovës, 2011

← MASHT, Kurrikula bërthamë e nivelit fillor, 2012, draft

← Korniza e Kosovës, Kurrikula Bërthamë për arsimin fillor Gusht 2011

Komunikim, ngërthen në vete këto lëndë: Gjuhë amtare, Gjuhë e parë e huaj (gjuhë angleze). Kjo fushë u mundëson nxënësve që të zhvillojnë përdorimin e gjuhës si mjet komunikimi në shkollë, në jetën e përditshme, në jetën profesionale dhe në jetën publike. Kjo është dhe një ndihmëse e madhe për mësimdhënësit dhe vlerësimet e tyre reale.

Analizë, interpretim të dhënash

Mostra e këtij studimi do të përfshijë 80 pjesëmarrës: mësimdhënës, drejtor shkollash dhe Entin Pedagogjik. Prej tyre 20 janë inspektorë pedagogjik të Departamentit të vlerësimit të performancës të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa 40 mësimdhënës të Gjuhës dhe letërsisë shqipe (Gjuhë dhe komunikim), si dhe 20 drejtorë të shkollave të mesme.

Kur i qasemi këtij punimi në metodat dhe metodologjinë e kërkimit do të kujtojmë thënien se: „*Gjithçka në shkencë vjen nga përvoja, çdo gjë që nuk ka lidhje me të nuk ka kuptim për shkencën*...”, pra edhe përzgjedhja e problemit në këtë hulumtim është marrë si nxitje e intuitës nga përvojat arsimore shumë vjeçare në mësimdhënie, inspektorëve pedagogjik dhe drejtorëve të shkollave në Kosovë. Ky fakt qartëson se kërkimi nuk ka elementet e një kërkimi themelor teorik, por mbetet në caqet e një kërkimi të zbatuar i cili është i lidhur ngushtë me aktivitetet dhe praktikatat e përditshme të mësimdhënësve të Gjuhës shqipe dhe letërsisë, inspektorëve pedagogjik dhe drejtorëve të shkollave. Nga kjo përcaktohet edhe natyra e pritjeve të studimit, pra pa ndonjë vlerë të madhe teorike e shkencore, po me një vlerë praktike të zbatimit në procesin që ka filluar. Për të identifikuar sfidat e këtij procesi në përgjithësi dhe për ti saktësuar ato të inspektorit përballë mësimdhënësve të arsimit parauniversitar, si koncept dhe sistem vlerësimi, kemi filluar me shpalosjen e përvojave të vendeve të ndryshme në këtë drejtim. Meqë në arsimin parauniversitar në Kosovë vlerësimi i performancës së mësimdhënësve është pilotuar në një numër të kufizuar të shkollave, 10 sosh, mundësitë për një hulumtim më të gjerë janë të kufizuara. Mirëpo¹⁰ në trajtimin e këtij problemi ishte e domosdoshme edhe rishikimi i përvojave të shteteve tjera. Analiza e përvojave nga trajnimet në Francë, SHBA dhe Shqipëri. Studimi është mbështetur fuqishëm në njohuritë e përgjithshme nga përvojat e fituara në vizitat në Francë, SHBA dhe në Shqipëri, ku janë trajtuar, debatuar dhe konkretizuar problematika të ndryshme arsimore me theks të veçantë në fushën e vlerësimit të mësimdhënësve. Lidhur me këtë kemi analizuar shembuj nga terreni në këto vende, si mënyrat e inspektimit, ashtu edhe shumë faktorë të tjerë të rëndësishëm të procesit të vlerësimit të shkollës dhe VPM në veçanti. ¹¹Hulumtimi vazhdon me analizën e të dhënave në procesin e pilotimit, ku janë shqyrtuar vlerësimet e inspektorëve pjesëmarrës në proces të cilët në vazhdimësi kanë reflektuar në udhëzuesin për monitorimin dhe vlerësimin e orës mësimore, me ç’rast janë veçuar momentet më sfiduese të këtij procesi. Hulumtimi ka filluar me analizën e vlerësimeve të 147 orëve të monitoruara nga 21 inspektorë të të gjitha rajoneve të Kosovës në 10 shkolla të niveleve të ndryshme ku janë përfshirë viset rurale dhe urbane. Analiza e instrumenteve të vlerësimit është përqendruar në dallimin e vlerësimeve ndërmjet inspektorëve, dallimin ndërmjet vlerësimeve të rajoneve dhe dallimet e vlerësimit të mësimdhënësve lëndor në dimensione të ndryshme. Pastaj është bërë një vështrim në dallimet ndërmjet vetëvlerësimeve të mësimdhënësve, vlerësimeve të drejtorëve të shkollave dhe vlerësimeve të inspektorëve me vështrim të veçantë në treguesit për standardin profesional. Analiza e të dhënave të instrumentit të vetëvlerësimit të mësimdhënësit, në pjesën ku mësimdhënësit flasin për anët e tyre të dobëta dhe të forta, janë nxjerrë një varg argumentesh për sfidat e mundshme të procesit në përgjithësi por edhe në kontekstin e temës, e në veçanti për analizën e debateve dhe punëtorive me inspektorë, drejtorë shkollash dhe drejtorë drejtorish komunale, në bashkëpunim me ekspertin e jashtëm, prej nga janë veçuar çështjet e rëndësishme në këtë proces pilotues të cilat do të jenë sinjalizime të vlefshme për zhvillimin e mëtejshëm të procesit. ¹²Në dokumentin për VPM, janë studiuar treguesit e përshkruar në dimensione dhe janë veçuar ata të cilët në vete përmbajnë standardin profesional për kompetencat e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Duke i analizuar të gjitha me radhë është vërejtur se disa nga treguesit lidhen me situata më sfiduese që e presin procesin e VPM, në gjendjen aktuale të sistemit tonë arsimor. Prandaj është përzgjedhur problemi brenda kësaj fushe dhe janë përcaktuar variabilet të cilat janë zbrërthyer në pyetje të dy lloj pyetësorëve (njëri për mësimdhënës dhe tjetri për inspektorë) që kërkojnë nga respondentët argumentet bindëse. Hartimi i pyetësorit për mësimdhënës është bazuar në analizat e mësipërme dhe i është shpërndarë vetëm 40 mësimdhënësve të shkollave të arsimit profesional të tri rajoneve të Kosovës të cilët kanë qenë të përfshirë në procesin e pilotimit. Kjo është mostra e përzgjedhur në numrin e përgjithshëm të mësimdhënësve, meqë sfidat më të mëdha në kontekstin e problemit të përzgjedhur parashihen kryesisht në arsimin profesional. Duke synuar vërtetimin e shkallës së pajtueshmërisë dhe kënaqësisë së tyre për vlerësimin e ardhshëm të inspektorit me profil tjetër arsimor, nga ai i mësimdhënësit që vlerësohet. Nga pyetësorët është marrë edhe një sinjal për shkallën e vështirësisë së mësimdhënësve për arritjen e këtij standardi si dhe për sfidat dhe rëndësinë e vlerësimit kompetent nga inspektori. Pyetësori për inspektorë është hartuar me pyetje pothuajse të njëjta në të cilat është synuar që të krahasohet mendimi i inspektorëve në raport me atë të mësimdhënësve për këtë çështje, për të nxjerrë një konkludim sa më të qëndrueshëm. Analiza e të dhënave nga pyetësorët e mësimdhënësve dhe inspektorëve dhe shqyrtimi i argumenteve të cilat e përkrahin dhe kundërshtojnë hipotezën e ngritur. ¹³Intervista me drejtorët e katër shkollave pilotuese për të marrë një perceptim të përgjithshëm të procesit të pilotimit dhe identifikimit të sfidave të cilat ata i kanë vërejtur në këtë proces. Gjithë kjo është analizuar në prizmin e teorive shkencore, raporteve vjetore të punës së institucioneve, artikujve

← Grup autorësh (2010): Kërkime Pedagogjike (Përmbledhje punimesh), Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë

← SWAP, Raport, Komponenta 3, Trajnimi dhe zhvillimi i mësimdhënësve, 2010

← Ibidem (fq.2)

← Ibidem (fq.5)

← UA 04/2012, Standardet e praktikës profesionale të drejtorëve të shkollave

arsimor dhe të përvojave të sistemeve të vlerësimit të vendeve të vizituara. Intervistë me ekspertë të arsimit dhe zyrtarë të MASHT-it, për verifikimin e arsyeshmërisë së hipotezës dhe marrjen e argumenteve nga zhvillimet e fundit për mundësinë e realizimit të rekomandimeve që synojmë të nxirren nga hulumtimi.

Konkluzione/ Rekomandime

Studimi i kësaj problematike ka një rëndësi të veçantë, së pari është një veprimtari specifike e mbikëqyrjes, vlerësimit dhe avancimit të mësimdhënies në arsimin parauniversitar në Kosovë, e cila duhet të fillojë nga vitit shkollor 2013-2014, nëse të gjitha përgatitjet realizohen me kohë nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Së dyti, kjo do të jetë një nga treguesit kryesor për licencimin e mësimdhënësve, në këtë rast të Gjuhës shqipe (Gjuhë dhe komunikim). Supozojmë se gjatë studimit do të përballemi edhe me një dukuri që mësimdhënësit e arsimit parauniversitar e konsiderojnë rolin e tyre në kompetencë profesionale duke mënjanuar faktin e nivelit të njohurive të nxënësve në Gjuhën shqipe, kur e kryejnë shkollën e mesme. Duke u nisur nga fakti se qëndrimi i mësimdhënësve karshi nxënësve, sidomos në procesin e vlerësimit, është problem kompleks, i cili ka qenë dhe është fushë e studimeve të ndryshme. Gjatë këtij studimi do të përballemi me këto probleme. Nota përfundimtare e nxënësve performohet në të shumtën e rasteve nga testet, angazhimet e tyre me punën në grupe, aktivitetet në orën mësimore, dosjet e tyre, diskutime dhe debate të ndryshme si dhe aktivitete të tjera që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me veçantitë e vlerësimit. Ndërsa vlerësimi i mësimdhënësve ka performancë dhe vlerësim tjetër, që duhet ti përmbahemi modeleve të mira të vendeve të ndryshme europiane që janë të cekura me lartë.¹⁴ Konstatimet e nxjerrura si përfundime dhe rekomandime të krahasuara me përvojat e vendeve tjera dhe me teoritë shkencore të deritashme për këtë problematikë të dhjetëvjeçarit të fundit. Në përfundim të këtij studimi, rekomandoj se do të hapen edhe probleme tjera, sidomos në çështjet:

- ← çështja e subjektivizmit të tri palët,
- ← familjarizimi i pamjaftueshëm i të gjithë pjesëmarrësve me dokumentin, standardet dhe treguesit e vlerësimit,
- ← mos harmonizimi i mjaftueshëm i qëndrimeve dhe qasjes për vlerësim ndërmjet inspektorëve,
- ← rastet e mospërputhjes së vlerësimit për më shumë se një shkallë, nuk janë të shumta dhe ato janë kryesisht në raportet mësimdhënës - inspektor.

Këto çështje mund të realizohen përmes hulumtimeve kërkimore dhe përvojave pa i lenë anësh dhe standardet e metodologjisë dhe praktikës se avancuar.

Bibliografia

- Udhëzimi Administrativ nr. 5/2010, datë 27.04.2010, *Licencimi i mësimdhënësve*, MASHT, Prishtinë KSHLM, MASHT, *Standardet dhe kriteret për Vlerësimin e Performancës së Mësimdhënësve*, gusht 2012, draft Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, *Standardet e zhvillimit profesional për inspektorin*, Tiranë 2010
- Salihu, Arbër (2008): *Zhvillimet në arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë gjatë viteve 2000-2006*. Temë e magistraturës, Fakulteti Filozofik, Nr. 1294/1, datë 11.09.08, Prishtinë
- SWAP, Raport, Komponenta 3, *Trajnimi dhe zhvillimi i mësimdhënësve*, 23 nëntor 2010 Departamenti i Arsimit të Vermontit, *Raport vjetor*, tetor 2009
- Zeneli, Isuf(2003): *Bazat e standardizimit dhe vlerësimit në arsim*, Libri Shkollor, Prishtinë Nicole Saginor, *Diagnostic classroom observacion*, SHBA, Vermont 2008
- SWAP, *Profili i kompetencave të mësimdhënies*, draft dokument
- Hoëard Garner, *Mendja e disiplinuar*, përkth. Hamlet Bezhani, Tiranë 2003
- MASHT, *Korniza e Kurrikulës së Kosovës*, 2011
- MASHT, *Kurrikula bërthamë e nivelit fillor*, 2012, draft
- Grup autorësh (2010): *Kërkime Pedagogjike (Përmbledhje punimesh)*, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë
- Republika e Maqedonisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Inspektorati Shtetëror Arsimor, *Treguesit për cilësi në punën e shkollave*, version punues, Shkup, 2009
- UA 04/2012, 02.05.2012, *Standardet e praktikës profesionale të drejtorëve të shkollave Udhëzues*, Standardet e vlerësimit, Nr. 490/01 B, 23.12.2011
- UA mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, nr. 13/2011, datë 30.12.2011
- Grup autorësh, Qendra për Politikën Arsimore Bolonjë, *Planifikimi i politikave dhe praktikave të përgatitjes së mësuesve për një arsim gjithëpërfshirës në kontekstin e diversitetit social dhe kulturor*, Raport vendor për Shqipërinë, dokument pune, 20 dhjetor 2009 Luciano Mariani, *Teacher support and teacher challenge in promoting learner, Perspectives*, a Journal of TESOL-Italy-Vol. XXIII, No. 2 Fall 1997
- Prof. asc. Pëllumb Karameta, *Arsimi në shekullin XXI*, revista Mësuesi, Tiranë, 20.11.2009
- Grup autorësh, Instituti Pedagogjik I Kosovës, *Ndikimet e trajnimeve në procesin mësimor*, Prishtinë 2008
- John Schacter, *Teacher Performance-Based Accountability: Èhy, Èhat and Hoë*, Santa Monica, CA 90401-1353
- Korniza e Kosovës, *Kurrikula Bërthamë për arsimin fillor*, Gusht, 2012

← Luciano Mariani, *Teacher support and teacher challenge in promoting learner, Perspectives*, a Journal of Tesol-Italy-Vol. XXIII, No. 2 Fall 1997

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë, 2011-2016

Recharad F. Elmor, Reforma shkollore nga brenda jashtë, politika dhe performanca, Tiranë, 2011

Burime nga interneti:

<http://books.google.com>, Kenneth D. Peterson, *Challenges in evaluation of teacher performance in evaluation of neë dimensions*, kapitulli

← *Neë direcion of teacher evaluation* sq.bep-ks.org, Trajnimi

i mësimdhënësve <http://www.naimfrasheri.org>, Xhemali Behluli,

Përsosja e mësimdhënësve

http://www.see-educoop.net/portal/id_kosovo.htm OECD, *Thematik Revië of National Policies for Education – Kosovo*, (e njëjta

në raportin e përkthyer në shqip, fq. 18).

TREGUES TË NDËRVEPRIMIT AKTIV NË KLASË

ROBERT GJEDIA

Pedagog i shkencave të Edukimit në Universitetin "Marin Barleti" Tiranë

FLORIAN KULLA

Pedagog i shkencave psikologjike në Fakultetin e Shkencave Sociale UT

ABSTRAKT

Artikulli "Treguesit e ndërveprimit aktiv në klasë" është një përpjekje profesionale për të përcjellë për grupet e interesuara të edukimit interpretime teorike dhe praktika të mira që lidhen ngushtë me ndërveprimin aktiv në klasë. Kjo filozofi, shumë e përçafuar, bazohet në pikëpamjet dhe modelet e teorive konstruktiviste dhe social-konstruktiviste të paraqitura qartësisht në kërkimet e Piazhës, por që kulmojnë me Vigotksin. Përmirësimi dhe reformimi i elementeve të kurrikulës, veçanërisht i proceseve të mësimdhënies dhe të të nxënit në kopshte dhe në klasat 1-9 është mbështetur pikërisht mbi këto praktika dhe këndvështrime bashkëkohore në sistemet arsimore, perëndimore. Ndërveprimi aktiv në klasë ose ndryshe në kontekstin arsimor shqiptar "Nxënësi në qendër të të nxënit" është pjesë e realiteteve pedagogjike në shumë klasa të sistemit tonë arsimor, por dhe në dokumentet zyrtare dhe në materialet profesionale, të publikuara për mësuesit. Autorët nëpërmjet shqyrtimit të literaturës, të pjesëmarrjes së tyre në projekte, por dhe me anë të të gjetjeve të siguruara nga përvoja personale, nga vëzhgime të shumta të orëve mësimore, nga diskutimet me mësues të profileve të ndryshme, nxjerrin përfundime për rëndësinë e zbatimit të ndërveprimit aktiv në klasë, i cili është gjithnjë në funksion të të nxënit. Artikulli arrin që të sistemojë dhe një listë me tregues të matshëm dhe të besueshëm që ndihmojnë aktorët e interesuar për të ndikuar në mënyrë të frytshme në pëmirësimin e proceseve të mësimdhënies dhe të të nxënit në shkollë.

Fjalë kyç: *Ndërveprim aktiv, teoritë konstruktiviste, tregues, mësimdhënie, të nxënë*

Karakteristika të ndërveprimit pedagogjik

Ndërveprimi pedagogjik

“Ndërvarësi ndërmyjet veprimtarive të nxënësit dhe të mësuesit”

Teoritë konstruktivistike dhe social-konstruktivistike me përfaqësues tipik Piazhën¹ dhe Vigotskin, më shumë se asnjëherë, po gjejnë mbështetje në dokumentet kurrikulare të shkruara, por sidomos në kurrikulën e zbatuar në shkollat e vendeve perëndimore. Pikëpamjet dhe praktikat, që sugjerojnë teoritë e cituara, bazohen thellësisht mbi ndërveprimin njerëzor, duke e rekomanduar atë në fushën e edukimit nëpërmjet ndërveprimit aktiv pedagogjik. Është ky ndërveprim që, sipas social-konstruktivistëve, shërben si një garanci për sukses në procesin e mësimdhënies, por dhe që format e shumëllojshme të të nxënësve sigurojnë arritje të dëshiruara të rezultateve nga fëmijët-nxënës.

Zhvillimi cilësor i proceseve të mësimdhënies dhe të të nxënësve në shkollat evropiane filloi atëherë kur proceset e ndërveprimit u panë si një formë e efektshme komunikimi në orët mësimore. Studiuesit, kërkuesit dhe autoritetet e kësaj fushe filluan të reagonin dhe doli e nevojshme që organizimi i të mësuarit të orientohej nëpërmjet formave të reja të komunikimit në klasë, të cilat sollën role të ndryshme të mësuesve dhe nxënësve, sollën mënyra të reja në transmetimin dhe marrjen e mesazheve mësimore midis dy partnerëve kryesore mësues-nxënës. Në përgjithësi, format pedagogjike që lidheshin me “pedagogjinë brenda një fëmije” ose zvogëlimin e proceseve të të nxënësve të tij, tashmë kishin nevojë për një patologji të shkollës dhe sidomos rreth të të nxënësve brenda klasës, por dhe në mjedisin social të shkollës.

Lidhja mësimdhënie-të nxënësve, tashmë e trajtuar në një frymë ndryshe, është sinjali i parë që ne na bën të kthehemi në natyrën e zhvillimit të procesit të të nxënësve në shkollë, që tashmë konsiderohet si një tip i ndërveprimit. Si rrjedhojë, ai tashmë është një formë e pashmangshme e marrëdhënieve midis njerëzve. Kështu **ndërveprimi** përfshin këto drejtime të rëndësishme të marrëdhënieve të tilla si: *pjesët përbërëse të njohjes, të vetëdijshme dhe të pavetëdijshme (rezistencat, konfliktet ose marrëveshjet afektive, paragjykimet ose anësitë) tërësinë e dinamikave komplekse të marrëdhënieve shoqërore (hierarkinë, dominimin, barazinë, diskriminimin etj) dhe të gjitha problemet dhe vështirësitë e proceseve të ndryshimit të sjelljes (të kuptuarit dhe të moskuptuarit, pengesat në komunikim, humbjet dhe shtrembërimin e informacionit).*

Parimi i dallueshëm i ndërveprimit dhe komunikimit pedagogjik lindi saktësisht nga karakteristikat origjinale të zhvillimit njerëzor. Kështu gjëja e parë dhe tipar i rëndësishëm i ndërveprimit pedagogjik është se **funkcioni themelor i tij është të nxënësve**. Kjo do të thotë se të nxënësve kuptohet në një sens shumë më të gjerë dhe përfshin të gjithë modelet e të nxënësve (kushtet, rrethanat, mbajtjen mend të fakteve, modelimin, por dhe aspekte komplekse të të nxënësve të tilla si: të nxënësve nga kërkimi ose zbulimi, eksperimentimi, zgjidhja e problemeve në mënyrë të pavarur, krijimi i njohurive në mënyrë individuale, ndërtimi shoqëror i dijeve, formatimi dhe sistemi i qëndrimeve, besimeve dhe vlerave etj.)

Karakteristikë e dytë, e rëndësishme e ndërveprimit pedagogjik është **natyra josimetrike e tij** e lidhur ngushtë me të nxënësve si një funksion themelor e tij. Natyra josimetrike mund të jetë vëzhguar në shumë rrugë të ndryshme si: në ndërveprimin midis një të rrituri dhe një të vogli, ndërveprimin midis një personi me zhvillim më të lartë dhe një tjetri me zhvillim më të ulët, ose mbi zhvillimin e shumë aftësive njëherësh ose më thjesht është një ndërveprim midis njërit që ka më shumë njohuri rreth disiplinave akademike dhe tjetrit që ka aftësi të mësojë shpejt ose kombinime të ndryshme të këtyre josimetrive, ku një sfidë e madhe dhe e përbashkët për praktikën shkollore paraqet dhe situata në të cilën fëmijët me një zhvillim të ulët mendor ose fizik demonstrojnë më shumë njohuri në disiplina të veçanta.

Karakteristikë e tretë, e veçantë e ndërveprimit pedagogjik është se **i tërë ndërveprimi është organizuar përreth shumë dijeve, shumë objekteve të njohurive**.

Ndërveprimi pedagogjik nuk është vetëm një marrëdhënie ndërpersonale, një marrëdhënie e dyanshme, reciproke, marrëdhënie midis individëve, por ndërveprimi pedagogjik ka si pjesë përbërëse të tij shumë njohuri dhe dije me të gjitha karakteristikat e natyrës së tyre.

Që njohuritë të ndërtojnë një korpus të vlefshëm dijesh³, duhet bërë i mundur sigurimi i sa më shumë njohurive në të, si dhe i të gjitha llojeve të ndryshme të njohurive të tilla si:

- ← njohuri konceptuale të ndryshme për fusha të ndryshme,
- ← njohuri praktike që lidhen me aftësitë e shprehitë,
- ← njohuritë procedurale që orientojnë nxënësin për njohjen e sistemeve të rregullave, të procedurave, të teknikave si dhe dhënien e përgjigjeve gjatë të nxënësve

Këto pikëpamje kanë gjetur zbatim në dokumentet e politikës arsimore aktuale në vendin tonë që kanë të bëjnë me përmbytjet e Kornizës kurrikulare, me elemente të metodologjisë të programet lëndore dhe apo dhe në detaje të imta profesionale në udhëzues për mësuesit për fusha dhe lëndë të ndryshme mësimore.

Pas viteve '90 të shekullit të kaluar kontribut të vlefshëm në fushën e praktikave të mira ndërvepruese, sidomos në fushën e metodologjive, ka dhënë zbatimin i shumë projekteve kombëtare të edukimit si:

1. Projekti “Step by step” mbështetur nga AEDP “Soros”

← Spiro Dion, “Fëmija dhe Piazhëja-teori të zhvillimit mendor” -Revista pedagogjike Nr.1, 1995, faqe 106-116

← Paund Linda, “How children learn” page 39, Lev Vygotsky, published by “Practical Pre-school Books” London 2006

← Carneiro, R. (2000) *Education 2000: On Knowledge and Learning for the new Millennium* (Sydney, Australian College of Education).

- ← Projekti “Edukimi i të drejtave të njeriut në shkollë” mbështetur nga Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut
- ← Projektim “Mendimi kritik përmes lexim-shkrimit” mbështetur nga AEDP “Soros”
- ← Projekti i parashkollorit “Montesori” mbështetur nga “UNICEF”, të cilët iniciuan dhe mundësuan zbatime konkrete në realitetet mësimore të klasave të ndërveprimit pedagogjik, kryesisht me anë të përdorimit të metodave, teknikave dhe strategjive të frytshme ndërvepruese dhe aktive që kanë në thelb të nxënësve, por sidomos stimulimin e tij.

Ndërveprimi aktiv në klasa tashmë është shumë i përfaqshuar nga mësues, nga nxënës dhe prindër, por dhe nga drejtues dhe inspektorë të shkollave. Për ndërveprimin aplikohen tregues përkatës⁴, por dhe instrumente për vëzhgimin dhe matjen e zbatimit të tyre, të cilat kanë identifikuar dhe kanë mundësuar përmirësime të mëtejshme të punës së mësuesve.

Treguesit e ndërveprimit të nxënësve

Analizat e shumta të orëve mësimore të realizuara brenda kuadrit të ndërveprimit pedagogjik kanë dëshmuar se si paraqiten fenomenet më esenciale të këtij ndërveprimi, në një mënyrë sa më të thjeshtë, duke na dhënë një listë me tregues se si nxënësit **ndërveprojnë në një orë mësimore**.

Çfarë nxënësit bëjnë dhe si, ose çfarë ata nuk mund të bëjnë dot, si dhe përcaktimet dhe arritjet mësimore, pedagogjike të gjithçkaje që është bërë në klasë.

Nisur nga fakti se çfarë nxënësit bëjnë ose nuk bëjnë në mësim, kjo mund të shërbejë për të identifikuar fakte të thjeshta rreth mënyrës së ndërveprimit të nxënësve, por themelore është një analizë objektive e veprimtarive të nxënësve, e cila kërkon një punë të lartë, profesionale dhe nuk synon vetëm që të analizojë se çfarë metodologjie është zbatuar. Ne do të shqyrtojmë për këtë shumë tregues ose aspekte të veprimtarive reale të nxënësve në procesin e të nxënësve.

Treguesitë kanë si qëllim të paraqesin analiza të pavarura të mësimdhënies së zhvilluar, të cilët janë të qartë dhe të lidhur ngushtë me procesin mësimdhënës dhe të të nxënësve.

Duke përdorur këtë linjë është e rëndësishme të japim këto sqarime rreth përbërësve të treguesve të ndërveprimit si më poshtë:

- ← Jo të gjithë treguesit që do të përmenden shfaqen brenda një orë mësimore (ajo varet nga natyra e lëndës, çështjet e mësimin, objektivat e mësimdhënies etj.)
- ← Treguesit e listuar më poshtë jo gjithmonë shfaqen me frekuencën dhe kohën e duhur (varen përsëri nga natyra e lëndës, si dhe faktorë të tjerë)
- ← Një analizë e mësimdhënies paraqet se cilët tregues dhe cilat lloje të veprimtarive janë evidentuar, sa nxënës janë pjesëmarrës në secilën veprimtari, sa zgjat secila veprimtari.
- ← Pas analizës së bërë rreth asaj se çfarë është bërë në një orë mësimore, analizat që pasojnë duhet të bëjnë të mundur përmirësimin e punës duke filluar që në planifikimet mësimore me një qëllim parësor, që lidhet me nxitjen e shkallës së veprimtarive të nxënësve, arritjen e një pavarësie të lartë nga ata, përfshirjen aktive të sa më shumë nxënësve sa të jetë e mundur në veprimtari, të qëndruarit e tyre aktivisht deri në përfundimin e veprimtarive, të cilat duhet të jenë të kuptueshme dhe të kenë lidhje me objektivat e dëshiruara.
- ← Gjëja themelore që duhet të dimë, kur përdorim këtë linjë është se ajo nuk është e dhënë njëherë e pandryshuar dhe e vetme, por ajo mund të shërbejë për të arritur objektivat/rezultatet mësimore ose për të ndërtuar dhe mundësuar analiza kritike dhe krijuese në të cilët zënë vend parësor përcaktimet dhe qëllimet e veprimtarive të nxënësve gjatë mësimëve, sa lidhje kanë ato përkatësisht me veprimtaritë e përzgjedhura, si dhe çfarë efektsh japin ato.

Treguesit në klasë⁷

Inisiativa e nxënësve është një tregues i qartë i veprimtarive të nxënësve.

Inisiativa e nxënësve mund të shfaqet në rrugë të shumta dhe në faza të ndryshme të procesit mësimor. Për ta përcaktuar sa më mirë këtë tregues duhet të përqendrohemi në sjelljet e nxënësve, të cilat e paraqesin iniciativën, si më poshtë:

- ← Fëmija deklaron ose jep sugjerime verbale, të përcaktuara.
- ← Qëndron dhe punon në mënyrë spontane në punë të ndryshme që janë planifikuar (tregon vëmendje dhe sjelljet e tij/saj shfaqin iniciativë).
- ← Nxënësit paraqesin vështirësitë që ata gjykojnë se ekzistojnë tek ata lidhur me arritjen e qëllimit mësimor, si dhe mënyrën e planifikuar për ta realizuar atë, duke dhënë argumente deri në hollësi për to.

← Udhëzuesi zyrtar “Inspektimi dhe Vlerësimi i brendshëm i shkollës” botim i IKAP, 2011, Fusha “Mësimdhënia dhe të nxënësve”

← Raportet vjetore, botime të IKAP për vitet 2010,2011,2012,2013, Vlerësimi i fushës “Mësimdhënia dhe të nxënësve”

← Huit, W. (2003). Models of teaching/instruction. *Educational Psychology Interactive*. Valdosta, GA: Valdosta State University

⁷ Borg, C. & Mayo, P. (2005) The EU Memorandum on lifelong learning. Old wine in new bottles? *Globalisation, Societies and Education*, **3**, pp. 203–225.

- ← Paraqesin vëmendje të lartë, origjinale, reagime të veçanta, përpiqen dhe provojnë të zgjidhin problema të ndryshme, gabojnë, të cilat bëjnë të mundur që dhe mësuesit të ndryshojnë mënyrën e tyre të punës.
- ← Inisiativa mund t'i referohet dhe përbërësve të ndryshëm të veprimtarisë që lidhen me materialin mësimor që përdoret ose jo, organizimin e punës në grup (përcaktimi dhe ndarja e roleve), çfarë është duke u bërë në grup, a nxitin mësuesit/et ose jo punën e pavarur të nxënësve, si ata sqarojnë ose instruktojnë për punën, i bëjnë të qarta në mënyrë më specifike objektivat që synohen, sa ata janë prezent individualisht ose në grupin e punës etj.

Është jashtëzakonisht e rëndësishme se sa mësuesi/sja ndan punën e tij/saj me iniciativat e nxënësve në veprimtaritë ndërvepruese, sepse të gjitha iniciativat e tij/ saj vlerësohen dhe merren në konsideratë nga iniciativat e nxënësve për përfshirje në të mësuar.

Pyetjet e nxënësve

Pyetjet e nxënësve në një orë mësimore janë një formë e veçantë e iniciativës së nxënësve. Në veçanti duhen përmendur dhe ato pyetje, të cilat nuk janë produktive dhe informative, por që janë shumë pozitive për aktivizimin e të menduarit të nxënësve.

- ← Bëhen pyetje gjatë një veprimtarie? Shpesh? Sa nxënës bëjnë pyetje?
- ← Janë ato pyetje të vërteta ose të pohuara? Ose pyetje që tërheqin vëmendjen e mësuesit/es?
- ← Natyra e pyetjeve: ato kërkojnë të shpjegohen (ka fjalë të panjohura në to, duhen shpjeguar konceptet), ato kërkojnë informacion të vazhdueshëm, çështje ose probleme të ndryshme për t'u trajtuar (një nxënës mund të ketë nevojë ose mund të shfaqë kontradikta lidhur me pyetjet që bëhen dhe ndihet nevoja e sqarimit të tyre, duke i lidhur dhe me përvojat personale të nxënësve), bëhen lidhje midis dy koncepteve akademike, të cilat duhen trajtuar veç e veç, bëhen pyetje rreth mundësisë së aplikimit të aftësive dhe njohurive që udhëzon shkolla etj.)
- ← Mësuesit/et reagojnë ndaj pyetjeve të nxënësve (kërkojnë një sqarim të pyetjeve të nxënësve, perifrazim të pyetjes, ndërhyjnë duke thënë se mendoni ju se kështu...) u kërkojnë nxënësve të tjerë që t'u përgjigjen pyetjeve të bëra, japin vetë një përgjigje, e cila ndikon tek nxënësit se si mund të jepet një zgjidhje, i nxitin ata që të bëjnë një përgjigje të kompletuar).

Vendimmarrja e nxënësve

Realizimi i vendimmarrjes është një akt që kërkon pavarësinë e nxënësve gjatë pjesëmarrjes së tyre në veprimtari. Vendimmarrja mund të ndeshet në dy situata të ndryshme: a) kur një mësues/e qëllimisht bën një plan mësimor, i cili kërkon dhe vendimmarrjen e nxënësve dhe që konkretisht nxënësit kanë vendin e tyre në këtë situatë ose mund të jepet në formën e një dileme, në të cilën ata duhet të bëjnë një vendimmarrje dhe b) kur nxënësit spontanisht kërkojnë të bëjnë vendimmarrjen mbi atë se çfarë të bëjnë, si ta bëjnë atë dhe kur mund të fillojë dialogu rreth tij.

Të gjitha llojet e sjelljeve të shfaqura gjatë vendimmarrjes bëhen në dy situata, të cilat lidhen me: kush e merr vendimin, mënyra në të cilën vendimi është bërë (p.sh., përmes diskutimeve), dilemat që ekzistojnë në vendimmarrje, sa e si zgjidhet, mbështetjen për të, e cila duhet të lidhet me aspektet për të cilat vendimmarrja duhet realizuar, duke parë se cilave problemeve u referohemi (çfarë duhet të bëjmë, si duhet ta bëjmë atë, ose në përgjithësi çdo gjë që duhet bërë). Është e një rëndësie të veçantë krijimi i një shkalle të saktë, si dhe i pavarësisë në vendimmarrje, si pjesë e punës së nxënësve, si dhe shtrirja e dukshme ose pranimit i fshehur i qëndrimeve të mësuesit/es.

Vlerësimi i sjelljeve të nxënësve

Vlerësimi i sjelljeve të nxënësve ka ta bëjë me atë se çfarë ata janë dukë bërë gjatë ndërveprimit pedagogjik, ose çfarë ata janë duke bërë në mësimdhënie (ose dhe pas mësimit), secili person për veten e tij ose për nxënësit e tjerë ose dhe mësuesi/ja. Vlerësimi i sjelljeve të nxënësve është një tregues i mirë i veprimtarive të nxënësve, sepse ato demonstrojnë qëndrimet personale të nxënësve, (e cila është mjaft e ndeshur në shkollë); lidhjet ose mos lidhjet, vlerësimi i të kuptuarit të nxënësve (janë ato të interesuar për të mësuar ose i konsiderojnë të dobishme njohuritë që marrin), përmes procesit të vlerësimit të qëndrimeve rreth përvetësimit të njohurive që ata zbulojnë, si dhe duke i lidhur me përvojat personale si dhe me sensin për t'i bërë ato të gjithëve)

Vlerësimi i sjelljeve mund të shfaqet në një formë direkte, verbale ose jo verbale e sjelljeve të tilla si: vlera e gjykimeve, përsëritja e vetëkritikës, qëndrimet e nxënësve. Rëndësi të veçantë këtu ka mënyra se si vlerësohen gjykimet e nxënësve, duke i lidhur me justifikimet që vetë ata japin.

Në secilën nga këto analiza duhet të gjenden hapësira ose pjesë, në të cilat në mënyrë të dukshme u kërkohet nxënësve të paraqesin sjelljet e tyre për vlerësim (shumë sjellje, produkte, sugjerimi se çfarë ata bëjnë dhe si e bëjnë atë, përfshirja e tyre në

← Welty, W. M. "Discussion Method Teaching: How to Make it Work." *Change*, July-August 1989

punë individualisht dhe në grup, justifikimi i tyre.) Vlerësimi i sjelljeve mund të shfaqë një nivel të procesit mësimor, ose mund të jetë fundi i një orë mësimore, në të cilën nxënësve u kërkojmë t'u japim mundësi për një vlerësim të përbashkët.

Reagimet emocionale

Reagimet emocionale⁹ janë një tregues i përvojës personale të asaj se çfarë ndodh gjatë procesit mësimor. Reagimet janë një tregues shumë i rëndësishëm i ndjenjave të nxënësve, por ato mund të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë me veprimtaritë përkatëse që realizohen në mësimdhënie të tilla si reagimet emocionale, estetike gjatë punës, emocionet intelektuale në përpjekjet personale për të gjetur të gjitha gjërat (p.sh : E gjeta ! “Eureka! etj.)

Reagimet emocionale mund të shfaqen në formën e verbalizimit të përvojave emocionale dhe më shpesh në formën e sjelljeve jo verbale (shprehitë e fytyrës, shikimi i syve, ngacmimet, toni emocional i zërit, të kënduarit ose në formën e produkteve (të vizatuarit etj.)

Reagimet psikomotorë

Reagimet psikomotorë mund të shfaqen përmes formave të gjesteve, lojëra në drama të vogla, rituale, vallëzime, imitime, pozat dhe qëndrimet e trupit (i tendosur ose i qetë, si dhe në veprimtaritë lëvizore etj.)

Këto reagime tregojnë rreth përvojës së përgjithshme të procesit mësimor mbi pjesën e përfshirjes së nxënësve, por gjithashtu ato mund të jenë tërësisht tregues përkatës të pjesëmarrjes aktive në mësimdhënie, kur ata përmes gjesteve, vallëzimit, shprehive dramatike, të cilat nxënësit e vegjël i paraqesin me një forcë të madhe, tërheqëse.

Produktet e veprimtarive

Produktet e veprimtarive¹⁰ janë padyshim tregues të një pune të gjatë dhe përfundimtare të një veprimtarie tashmë të mbyllur. Këtu duhen analizuar shpeshitë e produkteve të krijuara, natyra e tyre dhe lidhja që ato kanë me veprimtaritë e pjesëmarrësve në proceset e të nxënësve. Është e nevojshme të analizojmë:

- ← Janë produktet e bëra nga nxënësit, të krijuara gjatë një veprimtarie, apo është një produkt i fazës parapërgatitore ose një produkt final.
- ← Në qoftes e kemi produkte, cilat lloje produktesh janë: të punës individuale ose punës në grup, është një tekst i lidhur, një vizatim, një model, një objekt, një raport, një skemë, një poster, një përmbledhje e shkruar e punës gjatë veprimtarive etj.
- ← Kush e ka bërë produktin: një nxënës në mënyrë individuale, grupi, e tërë klasa në bashkëpunim me mësuesin.
- ← Çfarë është bërë me produktin gjatë mësimit: është prezantuar përpara klasës, grupit, është krahasuar, është analizuar në mënyrë kritike dhe a ka nxitur përmirësimin konstruktiv të tij, është bërë ose jo objekt i diskutimeve.
- ← Çfarë është bërë me produktin pas mësimit: asgjë, autorët ua tregojnë atë të tjerëve, e ruajnë për ta përdorur atë më vonë, e përdorin për të luajtur, e paraqesin jashtë grupit, klasës nga i cili është bërë, e tregojnë shpeshherë në klasë dhe ndonjëherë dhe në shkollë, janë duke e botuar në rrugë të tjera për ta bërë publike, e ekspozojnë në një vend të dukshëm dhe e përdorin në mësim.

Karakteristikat e veprimtarive përkatëse

Ky është një tregues kyç për një veprimtari, jo vetëm nga objektivi i mësimdhënies dhe të nxënësve që synohet, por dhe se si ato shfaqen dhe zhvillohen pikërisht në një veprimtari, por në një veprimtari të tillë, që ka lidhje specifike dhe domethënëse me njohuritë e lëndës akademike, por dhe me veprimtarinë, e cila është inicuar në vendin e parë.

Kjo nënkupton se natyra e veprimtarisë ka një rëndësi të madhe. Në fjalë të tjera, çdo veprimtari duhet të jetë në përputhje me natyrën e veçantë të përmbajtjes akademike të lëndës shkollore, e cila është zhvilluar. Përmbajtja kurrikulare dhe objektivat e një bllok mësimor përcaktojnë natyrën e veprimtarisë. Matematika kërkon shpesh veprimtari të veçanta matematikore, leximi përmban veprimtari leximore dhe kritike, artet janë për veprimtari artistike etj.

Ky tregues është një kriter kyç për vlerësimin, në qoftë se janë zbatuar parimet e të nxënësve aktiv në procesin mësimor. Gjithmonë, fillimet nga lidhjet e veprimtarive me rregullat përkatëse janë të qarta, janë evidente në praktikën e shkollës dhe duhet të shfaqen së paku në tri forma:

1. Në çdo veprimtari mësimdhënie/të nxënë ne kemi ushtrime nxemje, pushime të shkurtra për humor, shlodhje etj., që

← Carneiro, R. (2013) Living by learning, learning by living: the quest for meaning, *International Review of Education*, **59**, pp. 353–372.

← Udhëzuesit 1-7 “Critical Thinking across Reading and Writing” of RWCT Project, botuar nga AEDP, 1999-2001

bëjnë të mundur krijimin e një klime ose atmosfere të përgjithshme, pozitive.

2. Lidhja e veprimtarive në lëndë të ndryshme shkollore mund të jetë një fakt, i cili mund të vendosë një segment objektiv dhe lidhës në mësimdhënie (artet dhe matematika, gjeografia dhe historia, fizika dhe matematika etj). Në të tilla raste qëllimi themelor është integrimi i njohurive, kështu që vetë veprimtaritë mund të jenë të rëndësishme për dy ose më shumë lëndë shkollore, sepse ato janë mbi një vijë kufitare ose lidhin lëndë të ndryshme shkollore.
 - ← Këto janë forma të përgjithshme, intelektuale të tilla se: sigurojnë informacion për njëri-tjetrin, njohin se si të përdoren burime të ndryshme informacioni, të njohin se si duhet ndjekur një dialog i argumentuar, të njohin se si duhet lexuar një tekst dhe të mbahet qëndrim kritik ndaj tij, të mësojnë të krijosh tekste të kohës etj. Këto forma të veprimtarive duhen përdorur në praktikën mësimore të të gjitha lëndëve shkollore. Përmes tyre mund të gjenerojnë teknika të mësimdhënies dhe të nxënësve të punës intelektuale që mund ta adaptohet dhe duhet të jetë kurdoherë një stimul për mësimin në të gjitha lëndët shkollore.

Në qoftëse përdorim shenjën X në materialin e mëposhtëm, për të shënuar psh në një lëndë shkollore, treguesit e veprimtarive përkatëse të nxënësve, në një pjesë të hollësishme të punës së tij, ato mund të jenë:

- ← Identifikimi i njohurive ekzistuese dhe i përvojave që kanë lidhje me temën që do të trajtohet.
- ← Sigurimi i pavarur i informacionit me temën përkatëse.
- ← Ndërlidhja e njohurive me temën (përvojat personale¹¹ që kanë lidhje, njohuritë e marra më parë nga shkolla për temën, njohuri të marra nga lëndë të tjera)
- ← Praktikimi i aftësive e shprehive përmes metodave, teknikave dhe strategjive edhe procedurave specifike.
- ← Puna individuale mbi tekst (një përpjekje për të kuptuar tekstin, të shikojë se çfarë nuk është e qartë, të bëjë pyetje, të gjykojë dhe të krijojë lidhje)
- ← Aplikimi i njohurive të temës (aplikimi, nëse e konsideron të mundshëm, në lëndë të tjera shkollore, në punët e çdo dite, duke e praktikuar në një aplikim)
- ← Të menduarit e lirë (përfshirë brainstorming) dhe kërkimi në lidhje me problemin e dhënë.
- ← Bërja e pyetjeve që kanë lidhje me temën, shtrimi i problemit për ta diskutuar dhe për të vjelur informacion nga përvojat e ndryshme të gjithsecilit.
- Loja me role (duke zgjedhur atë që ka lidhje specifike me temën) duke argumentuar diskutimin rreth problemit).
- ← Duke krijuar një tekst ose edhe një produkt.
- ← Pikëpamje kritike dhe vlerësuese mbi shumë probleme, shpjegimin e kësaj pikëpamje, formimin e qëndrimeve personale dhe përcaktimin e të kuptuarit të njohurive nga ana e nxënësve (të pyeturit që lidhet me të kuptuarin e njohurive tek një nxënës në mjedisin e tij/të saj, një aplikim personal i mundshëm i njohurive të marra ose i shprehive të fituara, të pyeturit, në qoftë se njohuria e dhënë është kuptuar ndryshe për një nxënës (reagimet e tipit : Çfarë e bën këtë të nevojshme për të gjithë?)

Të gjitha format e aktivizimit të nxënësve në procesin mësimor kanë vend si pjesë të procesit mësimor, si një ndërveprim pedagogjik në të cilin ndahen veprimtaritë me mësuesin/en (si një partner më shumë kompetent) dhe nxënësien/en.

Pavarësia e nxënësve në veprimtari

Kur një mësues/e me planin e tij/të saj të mësimdhënies (një mësim, ose një bllok të mësimëve) i vendos nxënësien në pozicionin e të filluarit të veprimtarive, - sa e bën të mundur ai/ajo që nxënësien të vijojnë sjelljet e tyre. Ja disa raste:

- ← U jep në mënyrë absolute dorë të lirë nxënësve (brenda një çështje të dhënë me kushtet dhe detyrat e kërkuara)
- ← Mbikëqyr në vijimësi veprimtarinë e nxënësve (i jep atij/asaj instruksione dhe porosi)
- ← Stimulon vazhdimisht pyetjet dhe përgjigjet dhe siguron fakte të tjera.
- ← U jep kohë të lirë nxënësve që të vazhdojnë analizat se çfarë ata janë duke bërë dhe në ndonjë veprimtari diskutime rreth gjërave të tyre nga jeta e përditshme)
- ← Ndërhyn në plotësimin e kërkesave të nxënësve (futet në diskutime me ta, jep sugjerime, diskuton iniciativat e ngritura).

Kështu në analizat e veprimtarive të nxënësve në mësimdhënie mbi shkallën aktuale të pavarësisë së nxënësve rol, përcaktues luan vëzhgimi i mësuesit/es përgjatë zhvillimit të secilës veprimtari, gjatë orës mësimore si:

- ← Nxënësi/ja të jetë komplet i/e pavarur për fillimin e realizimit të iniciativave të mësuesit/es.
- ← Nxënësi/ja aktivizohet nga iniciativa e mësuesit/es, por është i/e pavarur nga ai/ajo.
- ← Këtu ekziston një ndërveprim i vazhdueshëm (një ndërveprim i dyanshëm i nxënësve me mësuesin/en)

← Halász, G. & Michel, A. (2011) Key competences in Europe: interpretation, policy formulation and implementation, *European Journal of Education*, 46, pp. 289–306.

Ndërveprimi i nxënësve¹²

Ky është një tregues i qartë i veprimtarive të nxënësve, në të cilën ndahet veprimtaria dhe ndërveprimi i nxënësve si një aspekt i rëndësishëm i komunikimit pedagogjik, me një funksion të veçantë arsimor (aftësi sociale, komunikative dhe edukuese, aftësi për bashkëpunim në grup, aftësi për të zgjidhur konfliktet në grup). Kurdoherë, është e rëndësishme analiza e secili model të mësimdhënies në përputhje me treguesit e mëposhtëm të ndërveprimit të nxënësve:

- ← Bën një konceptim të mësimit në mënyrë të pashm angshme për të drejtuar ndërveprimin midis nxënësve (për më tepër bashkëpunimin ose konfrontimin) ose bën atë që të marrë pjesë në veprimtaritë individuale?
- Identifikon nëse ndonjë element ndërveprues nuk është planifikuar në një mësim dhe në këtë rast mësuesi duhet të realizojë në mënyrë spontane elementë të tillë si p.sh: Një nxënës bën komente ose pyetje, i nxit përpjekjet e tyre për të nxënë, i pranon ato dhe organizon ndërveprime të tjera, por dhe i ndryshon ato sipas rastit në klasë.
- ← Në qoftë se ndërveprimi dhe ndryshimi midis nxënësve është planifikuar dhe përbën një bashkim të ideve të mësimit, cilat forma të ndërveprimit dhe të ndryshimit dominojnë?
 - ← Shkëmbimi i ideve dhe informacionit.
 - ← Bashkëpunimi, uniteti.
 - ← Konfrontimi dhe konflikti intelektual.
 - ← Dialogu argumentues (diskutimi, debati)
 - ← Loja me role dhe rotacioni në këto role.
 - ← Iniciativa nga një grup i nxënësve dhe përgjigjja nga një grup tjetër.
 - ← Vendimmarrja e ardhur nga diskutimi.
 - ← Përcaktimi i një pikëvështrimi.
 - ← Bashkëlidhja dhe trajtimi jashtë veprimeve.
 - ← Krijimi i një produkti të përbashkët (tekst, vizatim, model, kompozim etj)
 - ← Ndarja e roleve në një veprimtari të përbashkët.
 - ← Konkurrimi, rivaliteti i njërit me të tjerët.
 - ← Organizimi, strukturimi i grupit dhe bashkëpunimi brenda tij, lidhja me konkurrimin e një grupi tjetër.

Atmosfera e përgjithshme në grup

Një atmosferë psikologjike në grup gjatë procesit mësimor mund të jetë një tregues i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejt i shkallës së cilësisë së veprimtarive. Kjo ka si qëllim të vëzhgojë e të japë të dhëna rreth klimës në klasë, të qetësisë, të murmuritjeve, të përqendrimit të madh mbi punën e nxënësve, të gjitha këto karakteristika të punës në grupe.

Të gjitha këto nuk e bëjnë të lehtë vlerësimin e atmosferës së përgjithshme në analizat mbi vëmendjen e veçantë që duhet të ekzistojë në klasë, duke i nxjerrë përmes treguesve objektivë të kësaj atmosfere të tillë si:

- ← Si është toni dhe emocioni i përgjithshëm mbi të cilën është duke u realizuar puna (pozitiv, negativ, i mërziur, interesant, indiferent në pjesë të ndryshme të nxënësve?)
- ← Cilat janë marrëdhëniet që dominojnë midis nxënësve (bashkëpunimi, uniteti, kombinimi i mençur i bashkëpunimit dhe unitetit, marrëdhëniet konstruktive dhe kritike, marrëdhënie të bashkëpunimit konstruktiv brenda grupit dhe marrëdhënie rivale në mes grupeve, drejtim të tyre etj)?
- ← Cili është toni emocional, dominues në marrëdhëniet midis mësuesit dhe nxënësve?
- ← U jepet mundësi nxënësve që në fund të veprimtarive të flasin rreth përvojave që ata kanë provuar në mësim (si ata u ndjenë, çfarë ata pëlqyen, a ishin ata të interesuar, të thonë se çfarë ata mësuan, çfarë ata sugjerojnë të ndryshojë)?

Bibliografia

Borg, C. & Mayo, P. (2005) The EU Memorandum on lifelong learning. Old wine in new bottles? *Globalisation, Societies and Education*, 3, pp. 203–225.

Carneiro, R. (2000) *Education 2000: On Knowledge and Learning for the new Millennium* (Sydney, Australian College of Education). Carneiro, R. (2013) Living by learning, learning by living: the quest for meaning, *International Review of Education*, 59, pp. 353–372. “Critical thinking across reading and writing” of RWCT Project, Udhëzuesit 1-7 botuar nga AEDP, 1999-2011

Halász, G. & Michel, A. (2011) Key competences in Europe: interpretation, policy formulation and implementation, *European Journal of Education*, 46, pp. 289–306.

Huitt, W. (2003). Models of teaching/instruction. *Educational Psychology Interactive*. Valdosta, GA: Valdosta State University

Johnson, R. T. and D. W. Johnson *The Cooperative Learning Center at the University of Minnesota*

Korniza Kurrikulare e Gjinnazit, botim i IKT, 2009

Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, botime të IZHA, 2013, 2014

¹² Johnson, R. T. and D. W. Johnson [The Cooperative Learning Center at the University of Minnesota](#).

OECD (2010b) *PISA 2009 Results: learning to learn -student engagement, strategies and practices* (Vol. Volume III) (Paris, OECD). Paund Linda, "How children learn" page 39, Lev Vygotsky, published by "Practical Pre-school Books" London 2006

Raportet vjetore, botime të IKAP për vitet 2010,2011,2012,2013, Vlerësimi i fushës "Mësimdhënia dhe të nxënëtit" Spiro Dion, "Fëmija dhe Piazheja-teori të zhvillimit mendor" -Revista pedagogjike Nr.1, 1995, faqe 106-116 "Step by step" project in Albania

Udhëzuesi zyrtar "Inspektimi dhe Vlerësimi i brendshëm i shkollës" botim i IKAP, 2011, Fusha "Mësimdhënia dhe të nxënëtit" Welty, W. M. "Discussion Method Teaching: How to Make it Work." *Change*, July-August 1989

PREMISAT JURIDIKE DHE SOCIALE PËR ARSIMIMIN E KOMUNITETIT ROM NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

DHURATA TURKU

Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan

IVA BALZA

Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan

ABSTRAKT

Artikulli "Premisat juridike dhe sociale për arsimimin e komunitetit rom në Republikën e Shqipërisë", synon të analizojë kuadrin ligjor shqiptar për arsimimin e pakicave etnike, kryesisht të minoritetit rom dhe të gjykojë mbi masat konkrete, që duhet të ndërmerren në terma praktikë për përmirësimin e situatës. Artikulli synon të sensibilizojë mësuesit në shërbim si dhe të tërheqë vëmendjen e të gjithë aktorëve dhe specialistëve të arsimit, që ta njohin dhe ta kuptojnë si duhet rëndësinë e ligjit për arsimin e minoriteteve, si dhe të nënvizojë domosdoshmërinë që të gjenerohen politika mbështetëse dhe të merren masa konkrete për ta bërë atë sa më shumë të njohur dhe zbatueshëm në shkallë vendi.

Fjalë kyç: *Ligj, minoritet, rom, arsimim, politikë*

Hyrje

Shumë nga fëmijët romë kur nisin klasën e parë nuk dinë gjuhën shqipe sepse në familjet e tyre përdoret gjuha rome, duke krijuar kështu vështirësi në ecurinë në mësim. Nisur nga këto vështirësi, në të shumtën e rasteve fëmijët romë detyrohen të lënë shkollën. Ky nuk është shkaku i vetëm i braktisjes së shkollës. Ka edhe mjaft shkaqe të tjera si p.sh niveli i varfërisë, konceptet e prindërve, niveli i ulët i arsimimit të tyre etj, që bëjnë që shumë fëmijë të ndërpresin shkollën. Duke qenë se arsimimi është domosdoshmëri për konkurrencën në tregun e punës, për integrimin social, për zhvillimin njerëzor në përgjithësi, është e nevojshme, që fëmijët romë të kryejnë si fillim arsimin e detyruar, si dhe një pjesë tjetër të vazhdojë studimet në të gjitha nivelet e arsimimit. Për të ndihmuar fëmijët romë për të vazhduar shkollat, duke pasur parasysh dhe vështirësitë ekonomike që kalojnë familjet rome dhe kushtet në të cilat jetojnë, shteti është përpjekur të ndjekë politika mbështetëse për këtë kategori fëmijësh. Rëndësi të veçantë në këtë drejtim merr edhe ligji për arsimimin e pakicave, analiza e të cilit përbën edhe thelbin e këtij punimi.

Qëllimi

Shqyrtimi dhe analiza e kuadrit ligjor shqiptar për arsimimin e pakicave etnike dhe gjykimin mbi masat konkrete, që duhet të ndërmerren në praktikë për gjenerimin e politikave mbështetëse, në mënyrë që ky ligj të jetë sa më shumë i njohur dhe i zbatueshëm për të gjithë.

Pyetjet kërkimore

- ← Pse sanksionohet për pakicat kombëtare, specifikisht e drejta për t'u arsimuar?
- ← A është kuadri ligjor shqiptar për arsimimin e pakicave etnike teknikisht i plotë dhe a inkorporon ai direktivat e BE dhe parime të Konventës antidiskriminim?

Hipoteza

Ligji aktual për arsimimin e komunitetit rom në Shqipëri është gjithëpërfshirës dhe i detajuar, por barazia në të drejtën për arsimim do të arrihet vetëm nëse do të vihen në lëvizje mekanizma eficientë për respektimin e tij.

Metodologjia punimit

Artikulli bazohet në metodën analitike dhe analizon tre çështje kryesore:

- ← Ligji "Për arsimin parauniversitar" është një ligj gjithëpërfshirës, ku sanksionohet në mënyrë taksative e drejta për arsimim e pakicave etnike.
- ← E drejta për t'u arsimuar, si një e drejtë kushtetuese, duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e barazisë (çdokush ka të drejtën për arsimim).
- ← Në kuadër të zhvillimit në terma praktikë të parimit të barazisë në fushën e arsimit vihet re që situata socio-juridike e minoriteteve në Shqipëri dikton trajtim të diferencuar.

Përshkrim i shkurtër

Romët janë një nga minoritetet që jetojnë në Shqipëri, i cili konsiderohet si minoritet gjuhësor. Studimet linguistike kanë vërejtur ngjashmëri të konsiderueshme midis gjuhës rome dhe disa prej dialekteve të gjuhës indiane, të cilat (sipas studiuesve) dëshmojnë për origjinën indiane të romëve. Ata jetojnë në Shqipëri qysh prej 600 vjetësh dhe u vendosën këtu ashtu si edhe në vende të tjera të Evropës gjatë periudhës midis shekullit të XIII-të dhe XV-të.¹

Regjistrimi i përgjithshëm i popullsinë në 2001 në Shqipëri nuk përfshiu pyetje mbi etnitë dhe identitetin gjuhësor, kështu që nuk ka të dhëna zyrtare mbi numrin e popullsinë rome në vend. Sipas llogaritjeve jo zyrtare, numri i romëve në Shqipëri varijon nga 80.000 deri në 150.000, ose nga 2,5% dhe 4,7% e popullsisë së përgjithshme.² Romët në Shqipëri përgjithësisht kanë nivel më të ulët arsimimi dhe kalojnë më pak vite në shkollë krahasuar me grupet e tjera të popullsisë. Niveli i regjistrimit të fëmijëve romë në institucionet e arsimit parashkollor është më i vogël se 10% e numrit total të fëmijëve romë që duhet të regjistrohen në këto institucione. Niveli i arsimimit, i shkrimit dhe këndimit i popullsisë rome është shumë më i ulët, sesa mesatarja në shkollë kombëtare. Të gjitha këto si dhe të dhënat e mëposhtme i referohen romëve të anketuar në një pyetësor të PNUD-it³. Numri i nxënësve romë në të gjitha nivelet e sistemit arsimor është dukshëm më i ulët, sesa numri i nxënësve

← Dekada e përfshirjes së romëve. Plani kombëtar i veprimtimit 2010-2015, fq 6

← Roma Education Fund. Raporti vlerësues Shqipëri, Tiranë 2010, fq 8-10

← Prekshmeria Shoqërore e Romëve në Shqipëri, UNDP Shqipëri, 2006, fq. 22

i të gjithë komuniteteve e tjera. Ka tregues të dukshëm që tregojnë se një numër i madh fëmijësh romë nuk e frekuentojnë shkollën fare ose e braktisin atë në klasën e tretë apo të katërt, ose qysh në muajt e parë të klasës së parë në shkollën fillore. Ky fenomen është akoma më i theksuar për vajzat rome.

Shkaqet e nivelit të ulët të arsimimit në komunitetin rom janë të shumta, por më i rëndësishmi është varfëria ekstreme. Të ardhurat mujore për frymë midis romëve janë 3.3 herë më të ulëta sesa ato të popullsisë jo-rome dhe shumë familje rome jetojnë në vështirësi për shkak të varfërisë ekstreme. Si rezultat i shkallës së lartë të analfabetizmit (48% e romëve e krahasuar me 3% e jo-romëve), një nivel i jashtëzakonisht të ulët arsimor dhe kualifikimi si dhe diskriminimit, romët kanë një numër më të lartë papunësie dhe papunësie afatgjatë krahasuar me popullsinë jo-rome. Romët në Shqipëri nuk kanë përfaqësim politik në formën e ndonjë partie politike. Megjithatë, menjëherë pas vitit 1990, u themeluan tri Organizata Jo-Qeveritare (OJQ) për të përfaqësuar romët në nivel kombëtar: Unioni Demokratik i Romëve në Shqipëri Amaro Dives, Rromani Baxt dhe Amaro Drom. Më pas, u themeluan OJQ të tjera dhe sot ekzistojnë gati 20 prej tyre.⁴

Shqipëria ka arritur të konkretizojë kuadrin ligjor duke ratifikuar shumicën e instrumenteve lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe duke aspiruar të përmbushë të gjithë kushtet legale dhe faktike të shtetit të së drejtës. Romët nuk njihen ligjërisht si minoritet i veçantë në Shqipëri; vetëm komunitetet etnike me shtete ekzistuese janë pranuar si të tilla, gjë që nuk përbën rastin e romëve, të cilët nuk kanë ndonjë shtet mbështetës. Kushtetuta e Shqipërisë (KSH) e vitit 1998 u dha romëve statusin e një minoriteti etnolinguistik.⁵ KSH i trajton parimet bazë të të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve, sepse strategjitë që ngrihen, aktet ligjore që hartohen dhe hyjnë në fuqi, duhet që patjetër të përfshijnë parimet bazike ndërkombëtare në hierarkinë e normave të së drejtës, të sanksionuara në kushtetutë. Po t'i referohemi instrumenteve ndërkombëtarë antidiskriminim, si p.sh konventave ndërkombëtare, marrëveshjeve ndërkombëtare antidiskriminim, etj. vihet re se ata theksojnë rëndësinë socio-juridike të së drejtës për arsimim si një ndër të drejtat bazike të çdo individi, i kujtdo përkatësie race, etnie, kulture, gjinie etj. Pra vihet re vënia e theksit tek trajtimi i barabartë, më tepër sesa tek diferenca midis pakicës etnike dhe asaj etnolinguistike. Romët mbeten një minoritet që kërkon një trajtim të diferencuar që të arrihet barazia.

Mungesa e një aksesit të barabartë në edukim është një nga çështjet më serioze në Shqipëri me të cilat përballen komunitetet e marxhinalizuara, përfshi romët. Shumë raporte, studime dhe vëzhgime kanë nënvizuar problemet me të cilat ndeshet komuniteti Rom në fushën e edukimit si mos ndjekja e shkollës, ndjekja jo e rregullt e saj, niveli i lartë i braktisjes, aksesit fizik në sistemin arsimor, aksesit ndaj materialeve të nevojshme për arsimim etj. Anketa në shkallë vendi e realizuar nga OSFA / SOROS gjatë muajit nëntor 2012 dëshmon se pavarësisht se shërbimi arsimor paraqitet i arritshëm fizikisht nga komuniteti rom, përdorimi i këtij shërbimi nuk është gjithmonë i mundshëm.⁶ Nëse do të analizonim kuadrin ligjor shqiptar me qëllimin e një analize të tij për të parë se sa akses i jep ai arsimimit të minoritetit rom do të duhet ta nisim nga instrumentet ndërkombëtarë. Fryma e instrumenteve ndërkombëtare vë theksin në disa elemente thelbësorë që janë:

- ← E drejta e personave që u takojnë pakicave kombëtare për të mbajtur identitetin e tyre mund të realizohet plotësisht në qoftë se u mundësohet arsimi në gjuhën amtare. Në të njëjtën kohë personat që u takojnë pakicave kombëtare duhet të integrohen në shoqëri duke mësuar gjuhën e shtetit. E drejta për arsimim për këtë target-grup është më komplekse, pasi përfshin gjuhën dhe kulturën amtare dhe gjuhën dhe kulturën e shtetit ku jetojnë.
- ← Gjatë zbatimit të instrumenteve ndërkombëtare nga të cilat përfitojnë personat që u takojnë pakicave kombëtare, shtetet duhet në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme t'u përmbahen parimeve qenësore për barazi dhe jo diskriminim.
- ← Nuk duhet harruar se burimet ndërkombëtare paraqesin minimumin e standardeve për t'u aplikuar. Parashikimet minimale ndërkombëtare apo detyrimet minimale që aktet ndërkombëtare sanksionojnë, janë të detyrueshme për t'u respektuar. Shteteve u lihet hapësirë e lirë veprimi për detajimin e parashikimeve minimale dhe për tejkalimin e tyre

Masat dhe burimet

Shtetet duhet të ndërmarrin masa konkrete për zbutjen dhe minimizimin e diskriminimit. Këto masa duhet të jenë në përshtatje me rekomandimet e ndërkombëtarëve. Shteti ynë, si një shtet me praktikë demokratike të re, duhet patjetër t'u referohet akteve ndërkombëtare, për zbutjen e diskriminimit dhe përfshirjen masive të pakicave në arsimin parauniversitar.

Aktet ndërkombëtare, në hierarkinë e burimeve të së drejtës renditen të dytat, gjë që dëshmon rëndësinë e tyre. Kushtetuta e Shqipërisë rendit burimet e së drejtës dhe aktet ndërkombëtare menjëherë pas saj, gjë që dëshmon rëndësinë e tyre. Në aktet ndërkombëtare përfshihen marrëveshje, konventa etj.

- ← Shtetet duhet t'u qasen të drejtave arsimore të pakicave në mënyrë proaktive. Aty ku duhet mund të ndërmerren masa të veçanta nga shtetet që në mënyrë aktive t'i zbatojnë të drejtat e arsimit në gjuhë të pakicës duke përdorur të gjitha mundësitë egzistuese individualisht dhe nëpërmjet ndihmës dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, sidomos në fushën ekonomike dhe teknike.

← Monitorimi nga Shoqëria Civile i Zbatimit të Strategjisë Kombëtare dhe i Planit të Veprimit të Dekadës Rome në vitin 2012 në Shqipëri, fq 20

← Ibid

← Ibid

- ← Shtetet duhet t'u mundësojnë institucioneve që përfaqësojnë pakicat kombëtare, që në mënyrë gjithëpërfshirëse të marrin pjesë në zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve të lidhura me arsimin e pakicave
- ← Shtetet duhet t'u japin autoriteteve lokale dhe kombëtare kompetencat e nevojshme për arsimin e pakicave, duke lehtësuar kështu pjesëmarrjen e pakicave në procesin e formulimit të politikës në nivel kombëtar ose lokal.
- ← Shtetet duhet të marrin masa për inkurajimin e përfshirjes së prindërve në zgjidhjen e sistemit arsimor në nivel lokal, duke e përfshirë arsimimin në gjuhën e pakicës.⁷

Parimet e mësipërme sanksionohen tek raporti i Komisionerit për Mbrojtjen e Minoriteteve, si një organ specifikisht i profilizuar për minoritetet.

Pse sanksionohet për pakicat kombëtare, specifikisht e drejta për t'u arsimuar?

E drejta për arsim hyn në kategorinë e të drejtave kushtetuese.⁸ Ajo trajtohet si një ndër të drejtat bazike dhe si e tillë nuk mjafton vetëm të përmendet taksativisht. Kjo e drejtë shihet e lidhur ngushtë me parimin kushtetues të barazisë, sipas të cilit në kushte të barabarta të gjithë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë.

Pse për pakicat kombëtare ka një trajtesë më specifike?

Rëndësia e një trajtimi të diferencuar për pakicat etnike duhet të shihet e lidhur ngushtë me argumentet e mëposhtme të cilat janë:

- ← Është detyrë e shtetit të gjejë e aplikojë mekanizma të përshtatur dhe proporcionalë, për realizimin në terma praktikë të parimit të barazisë. Shteti duhet të marrë përsipër jo vetëm hartimin dhe miratimin e ligjeve, që mbrojnë e diktojnë të drejta, por edhe të garantojë funksionin e tij ekzekutiv nëpërmjet politikave konkrete.
- 2. Backgroundi socio-kulturor, i kësaj kategorie dëshmon nevojën e gjallë për një trajtesë me specifike.

E drejta për arsimim duhet të prekë çdo kategori, por kushtet socio-kulturore e treguesit konkrete diktojnë në **absolut** nevojën e ngritjes dhe aplikimit të mekanizmave specifikë për kategori specifike. Në kuadër të parimit të barazisë, i lidhur ngushtë me çështjen e së drejtës për arsimim do të shihet edhe parimi i proporcionalitetit, ky i fundit një parim kushtetues. E thënë ndryshe, pakicat kombëtare hyjnë në kategorinë e grupeve sensitive ose vunerabël, e si të tilla duhet të trajtohen në mënyrë të diferencuar për të arritur barazinë me kategoritë e tjera.

Hapat e trajtimit të diferencuar duhet që patjetër të jenë proporcionale me situatën që i dikton. Thelbi i parimit të barazisë është: trajtim i barabartë në kushte të barabarta. Pikërisht arritja e kushteve të barabarta për pakicat kombëtare, në raport me pjesën tjetër të popullsisë, kërkon mekanizma sui generis (të një lloji të veçantë). Kushtet e barabarta janë një element kyç që paraprin trajtimin e barabartë.

Cilat janë mekanizmat që duhet të vënë në lëvizje shtetet?

Mekanizmat kyç e fillestare janë ato ligjore. Shteti ynë, si shtet i së drejtës sanksionon të drejtën për arsim që në kushtetutë, për të vazhduar me pas me ligjet konkrete. Pas viteve '90, siç dihet, shumë vende europiane të dala nga regjimet totalitare u përfshinë në reforma të gjera edukative, për të rindërtuar dhe ribërë sistemet edukative të rënuara nga sistemi, me qëllim që t'i përgjigjeshin erës europiane dhe zhvillimeve botërore globale në arsim. Shqipëria, si një ndër këto vende, u përfshi në valën e këtyre ndryshimeve, të cilat sigurisht morën kahjen e reformave progresive në edukim dhe u orientuan drejt prirjeve të kohës, të tilla si: depolitizimi i sistemit arsimor, modernizimi i sistemit, globalizimi, decentralizimi, arsimit për të gjithë, të mësuarit për gjatë gjithë jetës, të nxënimit në shoqërinë e dijes, respektimi i të drejtave njerëzore, barazi dhe cilësi në arsim, gjithëpërfshirja, antidiskriminimi etj.

Ligji për arsimin parauniversitar nr 69/2012⁹, i vendit tonë në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 e kushtetutës, thotë shprehimisht

- ← Personave, që u përkasin pakicave kombëtare, u krijohen mundësi të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën amtare, të mësojnë historinë dhe kulturën e tyre, sipas planeve dhe programeve mësimore.
- ← Për të mundësuar pjesëmarrje aktive dhe të barabartë në jetën ekonomike, shoqërore, politike e kulturore të Republikës së Shqipërisë, nxënësve të pakicave kombëtare u krijohen kushte për mësimin e gjuhës shqipe dhe njohjen e historisë e të kulturës shqiptare.

← OSCE High Commissioner on National Minorities, faqe 26

← Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, neni 6, pika 5, Tiranë 2012, faqe 4404

← Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, neni 10, Tiranë 2012, faqe 4405,

- ← Planet e programet mësimore, si dhe raportet e përdorimit të gjuhës amtare dhe asaj zyrtare në procesin mësimor përcaktohen me akte të veçanta të ministrit.

Duket qartazi në këtë nen, sanksionimi i parimit të barazisë, sikundër është një trajtim disi më specifik për këtë target grup. Ky trajtim i diferencuar vjen si nevojë për mësimin e të dy gjuhëve. Në mënyrë të koncentruar në ligj pasqyrohen qartazi jo vetëm parimet kushtetuese, por edhe ato ndërkombëtarisht të pranuar.

Duke u nisur nga problemet e mëdha që paraqet pakica rome në Shqipëri në lidhje me arsimimin e saj, mund të themi se problemi nuk qëndron tek kuadri ligjor shqiptar. Kuadri ligjor në Shqipëri, për arsimimin e pakicave etnike, në aspektin teknik është i plotë dhe inkorporon direktivat e BE dhe parime të Konventës antidiskriminim. Shqipëria si shtet i së drejtës sanksionon të drejtën për arsim që në Kushtetutë, për të vazhduar me pas me ligjet konkrete.

Atëherë ku qëndron problematika?

Problematika qëndron: Tek faza post miratim e ligjit. Kjo fazë lidhet me politikat ekzekutive të shtetit që duhet të përfshijnë të gjithë institucionet përgjegjëse.

Analiza e çështjeve të mësipërme arrin në konkluzionet e mëposhtme:

Konkluzione

- ← Duhet të hartohen strategji afatmesme dhe afatgjata ku jo vetëm të implementohen parimet kryesore ndërkombëtare, por edhe të përshtaten me kushtet dhe nevojat specifike dhe konkrete të vendit tonë. Kjo ndryshe njihet me termin politika ekzekutive, pra detajim i ligjit dhe akteve nënligjore me politika konkrete.
- ← Ministritë e linjës, në kuadër të fondeve IPA¹⁰, duhet të ndërmarrin projekte dhe të kërkojnë ndihmën e mbështetjen e të huajve. Fondet IPA të vëna në dispozicion të shteteve duhet të përdoren me eficientë të lartë, në mënyrë që të arrihen rezultate konkrete dhe të matshme.
- ← Politikat ekzekutive për zbatimin e legjislacionit duhet të bëhen më konkrete, të intensifikohen dhe të diferencohen, të përfshihen grupet e interesit dhe institucionet përgjegjëse
- ← Institucionet përgjegjëse duhet ta kanalizojnë veprimtarinë e të ndërmarrin masa konkrete për arsimimin e pakicave etnike
- ← Për pakicat etnike, bazuar në kontekstin socio-kulturor nga ata vijnë, duhet një trajtim i diferencuar për aplikimin e parimit të barazisë në fushën e arsimit.
- ← Duhet vënë në dispozicion nga ana e shtetit e burimeve njerëzore, financiare dhe institucionale për realizimin e strategjisë për pakicat etnike në fushën e arsimit
- ← Duhet të stabilizohen mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit, të zbatimit të strategjisë kombëtare për pakicat rome dhe egjiptiane në vendin tonë.

Bibliografia

Dekada e përfshirjes së romëve. Plani kombëtar i veprimit 2010-2015, 6.

Roma Education Fund. Raporti vlerësues Shqipëri, (2010), 8-10.

Prekshëmëria Shoqërore e Romëve në Shqipëri, UNDP Shqipëri, (2006), 22.

Monitorimi nga Shoqëria Civile i Zbatimit të Strategjisë Kombëtare dhe i Planit të Veprimit të Dekadës Rome në vitin 2012 në Shqipëri, 20

OSCE High Commissioner on National Minorities, 26

Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, neni 6, pika 5, Tiranë (2012), 4404, 4405

← Instrumente të ndihmës financiare para aderimit

MIRËQENIA E NXËNËSVE NË SHKOLLA, SI NJË DUKURI EDUKUESE

ENKELEDA STEFA

Doktorante në Universitetin Europian të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Profili Pedagogji

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij kërkimi është të nënvijëzojë rëndësinë që kanë shkollat në zhvillimin e projekteve edukative që synojnë mirë-qenien dhe shëndetin e mirë të nxënësve, të kuptuara si mundësi formuese, projekte që kanë për qëllim të gjenerojnë praktika mbështetëse për vënien në ekuilibër të faktorëve që kontribuojnë në zhvillimin e personalitetit të nxënësve. Objekt i kësaj teme është identifikimi i përkufizimeve të mirë-qenies, duke u nisur nga mendimet e shprehura nga grupet e interesit: nxënës, mësues, prindër, drejtues shkollash dhe psikologët e zhvillimit. Ky kërkim synon të mbledh konceptimet reale të mirë-qenies së fëmijëve dhe adoleshentëve, si koncept psikologjik në një kontekst social-kulturor. Do të mblidhen të dhëna të lidhura ngushtë me kërkimin e përkufizimeve të mirë-qenies së fëmijëve dhe adoleshentëve, përmes përdorimit të metodave cilësore që përfshijnë fokus grupet me nxënësit, prindërit, mësuesit, dhe intervista me drejtorët e shkollave dhe disa psikolog zhvillimi. Më specifikisht, kërkimi do të drejtohet nga pyetjet që vijnë: Çfarë është mirë-qenia psikologjike? Çfarë është dhe çfarë e përcakton një ambient shkollor të shëndetshëm? Cilët faktor influencojnë në mirë-qenien e fëmijëve dhe adoleshentëve? Cili është roli që luan shkolla në promovimin e mirë-qenies psikologjike të nxënësve të vet? Cilat janë rrugët e duhura përmes të cilave të mund të promovohet mirë-qenia psikologjike e fëmijëve dhe adoleshentëve? Në kërkim do të përfshihen 100 nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, në dy seanca të mbledhjes së të dhënave. Gjatë pjesës së parë, të fokus grupeve, do të kërkohen aspekte të llojit të përgjithshëm që kanë të bëjnë me rolin e prindërve, mësuesve dhe shokëve, në mbështetjen e nxënësit. Në një pjesë të dytë, do të kryhen intervista individuale në lidhje me burimet e stresit dhe të mbështetjes ndaj tij.

Fjalë kyç: *mirë-qenie, fëmijë, adoleshent, edukim.*

Hyrje

Ne njerëzit shpesh themi “Shëndeti mbi të gjitha”, një fjalë e urtë kjo shumë e gjetur e cila nuk e humbet kurrë vërtetësinë e saj. Si nxënës dhe si mësues kam vënë re se nëse nuk ndihesh mirë, edhe dëshira për të punuar e mësuar nuk është e gjallë, përkundrazi, tentojmë të neglizhojmë detyrat dhe të pushojmë ose të kryejmë një aktivitet tjetër, më argëtues. Të ndërjet mirë është një proces kompleks që përfshin jo vetëm veten tonë por edhe ambientin dhe shoqërinë përreth nesh. Mirëqenia individuale ndërvepron me shoqërinë dhe ambientin përreth duke ndikuar dhe duke u ndikuar nga ata.

Shpesh dëgjojmë shprehjen “Një mendje e shëndosh në një trup të shëndosh”, shprehje e cila jo vetëm është shumë domethënëse por edhe shumë e vërtetë. Dy elemente të trupit të njeriut këto që nëse njëra nuk funksionon siç duhet, ndikon shumë në mirëfunksionimin e tjetrës.

Por nevoja për të qenë i shëndetshëm, sigurisht nuk ka lindur sot. Ajo daton që në fillimet e njerëzimit dhe është zhvilluar hap pas hapi me evoluimin e tij. Që herët flitej për gjetjen e mundësive për një shëndet të plotë, si të shmangeshin sëmundjet e ndryshme e si të shëroheshin ato, apo të gjendeshin kurat për to. Më pas u përhap ideja që më mirë të parandalosh sesa të kurosh, e kështu janë bërë hapa gjithmonë e më të rëndësishëm drejt shëndetit të mirë të njeriut. Më parë, një sëmundje e caktuar shikohej si e shkëputur nga pjesët e tjera të trupit, pra nuk ndikohej nga ato dhe nuk ndikonte në to, por më vonë u pa se në trupin e njeriut, një anomali në një organ apo pjesë të caktuar ndikonte në pjesët e tjera të trupit por edhe në gjendjen psiko-fizike të tij. Kështu që sëmundjet patologjike filluan të shikoheshin si diçka që ndikonin në anën psikike, psikologjike dhe anasjelltas.

Qëllimi i të gjithë neve është të ndihemi mirë, në të gjitha aspektet e kësaj fjale, e për këtë çdo ditë përpiqemi e punojmë për të patur një jetë të ekuilibruar dhe një shëndet të mirë. Çdo ditë e më tepër po flitet për arritjet e standardeve më të larta të një jetese të mirë e politikave e shumë vendeve të zhvilluara janë drejtuar drejt shëndetit të mirë nëpërmjet guidave të ndryshme se sit ë jetojmë shëndetshëm. Vihet re rëndësia që ka edukimi, që në moshat e hershme, për një jetë të shëndetshme duke përfshirë këtu jo vetëm parandalimin dhe kurimin e sëmundjeve, por madje ndjekjen e një higjienë e regjimi ditor të cilat kontribuojnë jo pak në një shëndet të mirë. E duke qenë se flasim për moshat e hershme, lind pyetja se ku më mirë se në shkolla të implementohen programe të tilla edukuese, e çfarë të përmbajnë këto programe për të edukuar moshat e hershme.

Shkollat mund të kontribuojnë shumë mirë në zhvillimin e programeve edukuese për një shëndet të mirë të nxënësve, të para në kuadrin e një mundësie formimi me qëllim vënie në ekuilibër të faktorëve që kontribuojnë në zhvillimin e personalitetit të tyre.

Nxënësit kalojnë një pjesë të konsiderueshme të kohës se tyre në shkollë. Aty, ata zhvillohen konjitivisht, hyjnë në kontakt me njeri-tjetrin dhe me mësuesit e mësojnë të krijojnë marrëdhëniet e para me ta. Shkollat janë një institucion arsimor e edukativ që u mundëson fëmijëve dhe adoleshentëve të socializohen dhe të vendosin pikëpamjet e tyre përballë pikëpamjeve të tjerëve.

Por asnjë individ nuk është një “tabula rasa” e gjithsecili mban në vetvete një bagazh të krijuar në familje apo në komunitetin ku ka kaluar fëmijërinë. Shkolla përveç se shërben si një institucion për arsimimin e nxënësve, është edhe vendtakimi i individëve të ndryshëm që sjellin me vete kulturën dhe zakonet e familjeve nga vijnë, të cilat gjejnë pika-shkrije me ato të tjerëve, për tu përmirësuar e zhvilluar më tej. Shkolla, si një institucion aktiv e veprues, ka për detyrë të njohë natyrën e nxënësve të saj, të kuptojë cilat janë fikat e forta të tyre, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të tyre, të identifikojë dobësitë e të punojë për kapërcimin e tyre, të vërejë gjendjen e përditshme të nxënësve dhe të jetë koshiente për problemet që ata shfaqin dhe të sugjerojë zgjidhje e bashkëpunim për një mbarëvajtje sa më të mirë.

Sipas këtij pikëvështrimi u zgjodh trajtimi i mirë-qenies si një dukuri edukuese në shkolla, pa përjashtuar rolin që luajnë familja, komuniteti dhe institucionet përkatëse shoqërore në problemet e ndryshme të këtyre grup-moshave. Shkolla, institucion i destinuar për formimin, rritjen dhe përvetësimin e ndërgjegjshmërisë e përgjegjshmërisë nuk duhet të kthehet në një vend të sikletshëm, ku qëndrimi në të bëhet i detyrueshëm dhe i mërzitshëm, ku nxënësit të ndihen të pakënaqur dhe të paduruar. Prandaj shkolla si një institucion aktiv duhet të vihet në lëvizje për të gjetur e promovuar zgjidhje. Shkolla luan një rol të rëndësishëm social suke edukuar breza të tërë njerëzish të cilët janë vazhdimësia e jetës. Për ta kryer sa më mirë detyrën e saj ajo duhet të ristrukturohet vazhdimisht dhe të gjejë burime të reja, për të qenë përkrah ndryshimeve që shoqëria paraqet. Duhet, ajo vet të formulojë, në bazë të nevojave dhe problematikave që paraqet, programe inovative që synojnë ndryshimin.

Është e vërtetë se shkolla nuk mund të shihet si e veçuar nga shoqëria përreth, prandaj ajo duhet të gjejë lidhjet me institucionet dhe burime të tjera, në funksion të finalizimit efikas të ndryshimeve të saj.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Edukimi ka në vetvete disa objektiva të rëndësishëm me karakter të përgjithshëm, ndër të cilët: promovimin e rezultateve të kënaqshme në mësim dhe zhvillimin e personalitetit dhe të mirë-qenies së nxënësve.

Ky kërkim ka për qëllim të nënvijëzojë rëndësinë që kanë shkollat në zhvillimin e projekteve edukative që synojnë mirë-qenien dhe shëndetin e mirë të nxënësve, të kuptuara si mundësi formuese, që kanë për qëllim të zhvillojnë e forcojnë mendime e praktika që mbështesin vënie në ekuilibër të faktorëve që kontribuojnë në zhvillimin e personalitetit të nxënësve.

Objekt i kësaj teme është studimi i përkufizimeve të mirë-qenies, duke u nisur nga mendimet e shprehura nga grupet e interesit: nxënës, mësues, prindër, drejtues shkollash dhe psikologët e zhvillimit.

Ky kërkim synon të mbledh konceptimet reale të të ndierit mirë të fëmijëve dhe adoleshentëve, si koncept psikologjik në një kontekst social- kulturor.

Do të mblidhen të dhëna nga komuniteti zonal, përmes përdorimit të metodave cilësore që përfshijnë fokus grupet, pyetësorët dhe intervistat e lidhura ngushtë me kërkimin e përkufizimeve të mirë-qenies së fëmijëve dhe adoleshentëve.

Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Rezultatet e studimit do të përftoheshin nga përpunimi i informacionit të përfshuar nëpërmjet fokus grupeve me nxënësit dhe mësuesit, nga pyetësorët me prindërit dhe intervistat me drejtuesit e shkollave dhe psikologët e zhvillimit.

Më specifiku, kërkimi do të drejtohet nga pyetjet që vijojnë:

- ← Çfarë është mirë-qenia psikologjike?
- ← Çfarë është dhe çfarë e përcakton një ambient shkollor të shëndetshëm?
- Cilët faktor influencojnë në mirë-qenien e fëmijëve dhe adoleshentëve?
- ← Cili është roli që luan shkolla në promovimin e mirë-qenies psikologjike të nxënësve të vet?

Cilat janë rrugët e duhura përmes të cilave të mund të promovohet mirë-qenia psikologjike e fëmijëve dhe adoleshentëve?

Hipoteza mbi të cilën është bazuar studimi në fjalë lidhet me çështjen:

Një marrëdhënie e mirë me mësuesit dhe prindërit, e kuptuar si mbështetje dhe komunikim jokonfliktual, ndikon pozitivisht në aftësinë për përshtatje shkollare dhe psiko-sociale të fëmijës dhe të adoleshentit.

Metodologjia i jep një kërkimi çfarëdo rregullat e kërkimit shkencor dhe mban një qëndrim kritik ndaj metodave dhe teknikave të përdorimit në praktikë.

Përmes përdorimit të metodave cilësore do të mblidhen të dhëna nga nxënësit e shkollave ku do të kryhet hulumtimi, mësuesit, prindërit, drejtuesit e shkollave dhe psikologët e zhvillimit. Do të mblidhen të dhëna përmes fokus grupeve dhe intervistave në lidhje me kërkimin e përkufizimeve të mirë-qenies së fëmijëve dhe adoleshentëve.

Mbledhja e fokus grupeve, pyetësorëve dhe intervistave individuale do të kryhet me qëllimin që të eksplorojë dimensionet objekt të kërkimit. Më saktësisht do përfshihen 100 nxënës të shkollave 9-vjecare dhe të mesme, në dy seanca të mbledhjes së të dhënave. Gjatë pjesës së parë, të fokus grupeve, do të kërkohen aspekte të llojit të përgjithshëm që kanë të bëjnë me rolin e prindërve, mësuesve dhe shokëve, në mbështetjen e nxënësit. Në një pjesë të dytë pyetjesh, do të procedohet me pyetësorët drejtuar prindërve, për të njohur qëndrimin e tyre në lidhje me situatat e ndryshme që hasin fëmijët e tyre në jetën e përditshme. Në fund do të kryhen intervistat individuale në lidhje me burimet e stresit dhe të mbështetjes ndaj tij.

Përveç sa u tha më sipër, fokus grupet, që mendohet të përfshijnë 40 mësues dhe pyetësorët që do ty drejtohen rreth 40 prindërve, do të përdoren edhe si sondazh në lidhje me gjetjen e karakteristikave të një ambienti shkollor, të aftë të promovojë mirë-qenien e nxënësve. Ndërsa intervistat individuale do të kryhen me qëllimin specifik për të përfshirë në kërkim përcaktimet psikologjike të mirë-qenies, dhe do të përfshijnë pesë drejtues shkollash e pesë psikolog të zhvillimit.

Diskutimet gjatë fokus grupeve, intervistat individuale për drejtuesit e shkollave dhe psikologët e zhvillimit, do të regjistrohen në audio e më pas do të përdoren për të bërë analizën e tekstit të shkruar.

Diskutimet gjatë fokus grupeve, pyetësorët dhe intervistat individuale për drejtuesit e shkollave dhe psikologët e zhvillimit, do të regjistrohen në audio e më pas do të përdoren për të bërë analizën e tekstit të shkruar.

Nga kërkimi pritet të arrihen rezultate që të tregojnë mbi të gjitha, se si një marrëdhënie e mirë me mësuesit dhe prindërit, e kuptuar si mbështetje dhe komunikim jokonfliktual, ndikon pozitivisht në aftësinë për përshtatje shkollare dhe psiko-sociale të fëmijëve dhe të adoleshentëve.

Shëndeti, mirë-qenia dhe fazat e zhvillimit të fëmijëve dhe adoleshentëve

Fazat e para të jetës kanë një rëndësi themelore për një zhvillim të shëndetshëm të mëvonshëm. Duke e vlerësuar këtë fakt, shumë studiues të mirë-qenies vënë theksin te koha e ndërhyrjes së promovimit të një shëndeti të mirë, si një investim i rëndësishëm për të ardhmen e individit dhe shoqërisë në të cilën ai bën pjesë. Sipas Ben-Arieh dhe Goerge (2006), mirë-qenia e fëmijëve vlerësohet edhe si një faktor që tregon nivelin shëndetësor dhe perspektivat në vijim të një shoqërie. Ata sugjerojnë madje se treguesit e mirë-qenies së fëmijëve përbëjnë një strategji të rëndësishme në monitorimin e suksesit të një shoqërie. Pozicionimi i fëmijëve drejt një rruge pozitive që herët në jetë ka treguar se ndikon në rritjen e suksesit shkollor të mëvonshëm.

Por nëse do të flasim për mirë-qenien e fëmijëve dhe adoleshentëve atëherë duhet ta shtrijmë vështrimin që në lindje dhe në muajt e parë të jetës së fëmijëve. Sipas Brazelton dhe Greenspan, studiuese të nevojave bazë të fëmijëve, edukimi i tyre fillon që në muajt e parë të jetës për të vazhduar më tej me rritjen e tyre. Pra s' mund të pretendojmë kurrësi të fillojmë edukimin e fëmijëve në moshën parashkollare dhe në shkollë. Është pikërisht fëmijëria e hershme koha kur hidhen themelet për një zhvillim intelektual dhe emocional të mirë të mëtejshëm. Edhe në një moshë të mëvonshme mund të kemi një zhvillim të tillë por do të duhet një investim më i madh dhe shanset për të patur sukses janë më të vogla. Besimi, simpatia dhe dhembshuria

janë ndjenja që fëmijët i zhvillojnë që në fëmijërinë e hershme nëse edukohen me kujdes dhe dashuri. Bashkëveprimi që ata shfaqin me fëmijët e tjerë ndihmon në zhvillimin normal të sistemit nervor qendror. Me përkujdesjen dhe edukimin që i japin një fëmije, prindërit përcaktojnë tiparet e personalitetit të fëmijës, të tilla si: aftësinë për të krijuar marrëdhënie me të tjerët, besimi dhe intimiteti, simpatia dhe mendimi logjik e kritik.

Në ditët e sotme prania e prindërve në kohën e fëmijëve është shumë e vogël, si rrjedhojë e orareve të gjata të punës dhe gjithmonë e më tepër kemi fëmijë që kohën e tyre e kalojnë duke parë televizor ose duke luajtur në kompjuter me orë të tëra. Kjo gjë jo vetëm që i bën fëmijët më pak kreativ por i izolon dhe i bën më asocial. Varfëria, dhuna, abuzimet dhe mungesa e ngrohtësisë familjare luajnë rolin kryesor në formimin e modeleve antisociale të fëmijët dhe adoleshentët, të cilët i shikojnë njerëzit përreth tyre si objekte sesa si qenie njerëzore. John Bowlby, ka përshkruar fëmijët të neglizhuar në fëmijërinë e hershme, të cilët janë shndërruar në antisocial të theksuar (Bowlby J., 1944). Për një zhvillim sa më të mirë fëmijët kanë nevojë për lojëra imagjinatë, diskutime të ndryshme, debate dhe biseda orientuese kryesisht me prindërit e tyre. Të gjitha këto nënkuptojnë kalimin e një kohe të konsiderueshme me fëmijën duke bashkëvepruar me të gjatë fëmijërisë së hershme dhe në moshën parashkollore (Brazelton T.B., Greenspan S.I., 2000).

Fillimi i klasës së parë shënon për fëmijën një fazë të re dhe delikate në jetën e tij. Është një kalim që kërkon mbështetje dhe siguri, nga prindërit dhe mësuesi, për ta ndihmuar të marrë përsipër detyrimet që i lindin në këtë periudhë, si respektim i orareve dhe rregullave, kujdesi për mjetet shkollore dhe librat si dhe kryerja e detyrave. “Hyryja në shkollën fillore përkon për fëmijën me plotësimin e një procesi rritjeje”, shpjegon Simonetta Gentile (Gentile S.), psikologe zhvillimi. Pritshmëritë kundrejt tij rriten si nga ana e mësuesit ashtu edhe nga prindërit. Fëmija duhet të përshtatet tashmë me një realitet të ri, i cili bazohet në rregulla dhe detyra. Për ta ndihmuar atë drejt një jete shkollore të mirë, familja luan një rol kryesor duke bashkëpunuar me të për t’u ambientuar në klasë për të kaluar pengesat e para, për t’u integruar me shokët, etj.

Në momentin kur fëmija fillon shkollën, bashkëveprimi me prindërit duhet të arrijë në nivele më të larta kreative dhe logjike. Koha e shpenzuar para televizorit apo në kompjuter duhet të jetë shumë e vogël sepse këto objekte nuk e pajisin fëmijën me aftësitë bazë. “Nëse zëvendësojmë faktorin njerëzor për teknologjinë, do të shndërrohemi në popullsi johumane”. Për të edukuar fëmijë të mirë, faktorët si bashkëveprimi dhe vendosja e marrëdhënieve, janë tepër të rëndësishëm. Për më tepër që nxisin edhe zhvillimin e trurit njerëzor, sepse fëmijët mësojnë shumë edhe nga loja me njëri-tjetrin (Brazelton T.B., Greenspan S.I., 2000).

Shkolla fillore është vendi ku fëmijëve u duhet të sillen sipas rregullave dhe të respektojnë bashkëmoshatarët e tyre, dhe këto dy aspekte nxjerrin për herë të parë në pah aftësitë e mësuarat ose jo gjatë viteve të fëmijërisë së hershme (St Leger, 2006). Shpeshherë prindërit e këtyre fëmijëve të cilët janë hiperaktiv, të pavëmendshëm, të paduruar dhe agresiv nuk e pranojnë, madje edhe e mohojnë këtë sjellje të fëmijëve të tyre për shkaqe të ndryshme, si niveli arsimor i tyre e kultura familjare (Durlak, 1995).

Fëmijët e moshës shtatë deri në njëmbëdhjetë vjeç, sipas fazave të zhvillimit konjitiv të Piazhës, janë në fazën e operacioneve konkrete. Në këtë stad të zhvillimit të tyre ata janë të vetëdijshëm për stabilitetin logjik të botës fizike, njohin mirë konceptin e konservimit e kuptojnë se elementet mund të ndryshojnë dhe të transformohen, por përsëri të ruajnë shumë nga karakteristikat e tyre fillestare. Njohin konceptin e klasifikimit sipas një karakteristike të vetme të objektit dhe mund të krijojnë seri duke organizuar objekte nga më të mëdhatë tek ato më të vogla dhe anasjelltas. Të gjitha këto aftësi së bashku tregojnë se fëmija ka zhvilluar më në fund një sistem të plotë dhe shumë logjik të të menduarit.

Në moshën gjashtë vjeçare e më tej fëmija fillon të vendos disa sjellje, marrëdhënie dhe emocione të cilat në të vërtetë janë rrënjësor tek ai që në muajt e parë të jetës së tij nëpërmjet lidhjes që ka përjetuar me familjarët më të afërt, kryesisht me nënën. Marrëdhëniet që vendosen midis të rriturve dhe fëmijëve luajnë një rol themelor në zhvillimin e personalitetit dhe aftësive shkollore në moshën parashkollore, në atë të shkollës fillore dhe në shkollën 9-vjeçare dhe të mesme. Është shkolla pra vendi ku dalin në pah aftësitë për t’u socializuar dhe zhvilluar psikologjikisht, të fituara në vegjëli (Pianta, 2001). Nga studimet e kryera mbi marrëdhëniet e ndryshme që lidhin fëmijët me të tjerët dallohen katër stile lidhjesh/atashimi, të cilat e kanë origjinën në muajt e parë të jetës së fëmijëve. Fëmijët e sigurt, zhvillojnë një ndjenjë pozitive kundrejt vetes dhe të tjerëve. Ata janë kuriozë dhe nuk hezitojnë, kanë një nivel të ulët ankthi, kanë besim të lartë në vetvete, socializohen lehtësisht me të tjerët. Modeli pozitiv i fëmijës së sigurt e drejton drejt një besimi të lartë në vetvete dhe një vlerësimi të lartë për të tjerët, nga të cilët konsiderohet si tip pozitiv. Në shkollë zakonisht dallohen si nxënës shume të mirë, të gatshëm e të motivuar dhe të mësuarit për ta nuk përbën problem.

Fëmijët që kanë zhvilluar një stil atashimi të pasigurt, ankthios, ambivalent kanë një ndjenjë negative për veten dhe pozitive për të tjerët. Ndjenja negative që fëmija ka për veten e çon drejt një vetëvlerësimi të ulët dhe drejt një varësie të gjykimit të të tjerëve për të. Modeli pozitiv që ka për të tjerët e çon në kërkim të vazhdueshëm të shokëve dhe të vëmendjes. Në shkollë këta fëmijë janë zakonisht nxënës të paqetë, të vështirë për t’u kujdesur për ta, me vështirësi të mëdha integrimi dhe mund të vënë në diskutim aftësitë edukuese të mësuesve. Për këta fëmijë është familja që kushtëzon dhe drejton përshtatjen ose jo të këtyre fëmijëve në shkollë.

Fëmijët e veçuar sipas modelit evitues, ushqejnë ndjenja pozitive për veten dhe negative për të tjerët. Pozitiviteti i fëmijëve të veçuar i drejton ata drejt besimit të lartë në vetvete pa marr parasysh gjykimet e të tjerëve edhe pse mendon se e konsiderojnë arrogant, dinak, kritik, serioz e të rezervuar. Mendimi negativ që ka për të tjerët e bën që të duket se nuk i vlerëson shumë të tjerët, e ndonjëherë të jetë cinik e tepër kritik. Këta fëmijë, që vijnë nga familje me afrimetet dhe mbështetje të ulët ndaj njëri-tjetrit, mund ta jetojnë shkollën me ankth dhe pengesa. Zakonisht janë fëmijë të heshtur, pak social, por shumë të zgjuar dhe duan të bëjnë për vete me dhuntitë që kanë.

Fëmijët e shqetësuar, të veçuar janë një tip tjetër, të cilët në moshën e hershme kanë elaboruar një afërsi të çorganizuar me të rriturit. Karakterizohen nga një negativitet për veten dhe për të tjerët. Ky negativitet që fëmija ka për veten bën që të ketë vetëvlerësim të ulët dhe shumë dyshime kundrejt vetes dhe të tjerëve. Negativiteti që ndjen ndaj të tjerëve e pengon t'u kërkojë ndihmë atyre, të evitojë konfliktet dhe të ketë vështirësi në krijimin e besimit ndaj të tjerëve (Ainsworth M.D.S., Bell S.M., 1970).

Fëmijët gjatë shkollës fillore kanë tendencën të ambientohen si me bashkëmoshatarët ashtu edhe me mësuesit nëse këta të të fundit janë të afrueshëm dhe tregojnë kujdes ndaj tyre. Nëse ndodh e kundërta dhe mësuesit sillen me autoritet dhe janë sipërfaqësor, bëjnë që fëmijëve, të cilëve u ka munguar apo e kanë patur të lëkundur afeksinin e të rriturve, të nxjerrin në pah agresivitetin ose të mbyllin në vetvete (Steele H., Steele M., Croft C., 2008).

Në moshën dhjetë-njëmbëdhjetë vjeçare fëmijët kalojnë nga shkolla fillore në atë 9-vjeçare dhe detyrat e tyre për sa i përket të mësuarit ndryshojnë dhe shtohen. Kjo periudhë përkon edhe me futjen në një fazë të re të jetës, adoleshencën. Studiues të ndryshëm shprehin ndryshe në lidhje me kohëzgjatjen e saj si edhe me detyrat për t'u zhvilluar, por këto të fundit varen edhe nga kultura dhe vendi ku një adoleshent rritet. Çdo klasë sociale e çdo grup influencën me specifikat e veta detyrat e ndryshme të zhvillimit. Sipas Havighurst, disa nga detyrat e zhvillimit që hasin adoleshentët janë:

- ← vendosja e marrëdhënieve të reja e më të pjekura me moshatarët e të njëjtit seks;
- ← ndarja e roleve gjinore femër- mashkull;
- ← pranimi i trupit vetjak dhe vënia e tij në funksion;
- ← krijimi i pavarësisë emocionale nga prindërit dhe të rriturit e tjerë;
- ← arritja e sigurisë e shkaktuar nga pavarësia ekonomike;
- ← orientimi dhe përgatitja drejt një punësimi apo profesioni;
- ← zhvillimi i kompetencave intelektuale dhe njohurive të duhura për arritjen e aftësisë qytetare;
- ← etj.

Këto karakteristika janë listuar për adoleshentët e bardhë të klasës së mesme amerikane të viteve '50 (Havighurst, 1953).

John Coleman, ka propozuar një model shpjegues për modalitete të ndryshme me të cilat detyrat e zhvillimit mund të zgjidhen duke arritur rezultate të kënaqshme. Sipas këtij modeli, në momente të ndryshme të adoleshencës çdo individ përballet me një sërë problemesh, për shembull: shqetësimi për ndryshimet fizike, ankthi në lidhje me marrëdhëniet heteroseksuale, frika e mospranimit në një grup moshatarësh, konflikti me prindërit, zgjedhja e sistemeve të ndryshme të vlerave, orientimi drejt një fushe profesionale ose një tjetre. Të gjitha këto detyra adoleshentët nuk mund t'i përballojnë në një periudhë të shkurtër kohe, sepse s'do t'ia dilnin. Më e vështirë, sipas Coleman, është për ata adoleshentët të cilët përveç këtyre problemeve «normale», duhet të përballen me probleme më të rënda, si pasojë e situatës në të cilën jetojnë, si për shembull të marrin përsipër shumë herët përgjegjësitë ekonomike të familjes së tyre, t'ju duhet të mbijetojnë në kushte ekstreme (si në rastin e fëmijëve të rrugës apo fëmijët që jetojnë në kushtet e luftës), braktisja e shkollës për t'u futur më herët në punë, shpesh me idenë se do të fitojnë një liri më të madhe, përjetimi i një handikapi që i bën të ndjehen të ndryshëm e të refuzuar nga bashkëmoshatarët (Coleman J.B., Dendry L., 1997).

Shumë nga këto probleme evidentohen lehtë nga mësuesit në shkollë, sigurisht nëse ata janë të vëmendshëm dhe të prirur për t'u kujdesur për nxënësit, jo vetëm në aspektin konjitiv por edhe në atë afektiv dhe emocional. Mësuesit janë ndërhyrësit e duhur në krizat që prekin fëmijët dhe përgatitja e tyre në këtë fushë është si praktike dhe e domosdoshme. Eksperienca e një semestri me fëmijët u jep atyre një pasqyrë reference të dobishme në identifikimin e sjelljeve të pazakonta. Kontakti i tyre i përditshëm me të njëjtët fëmijë u jep atyre mundësinë të vërejnë ndryshimet në sjellje të çdo fëmije. Këta faktorë rrisin shansin për të patur sukses në parandalimin dhe "copping" me krizat në shkollë. Me përgatitjen e dukur, mësuesit mund të bëhen një nga burimet më kryesore për parandalimin e krizave dhe ndërhyrjen në to, në shkollë. Problemet emocionale në familje dhe marrëdhëniet e vështira me prindërit dhe figurat e tjera autoritare janë dy faktorë risku shtesë të sugjeruara nga literatura e shëndetit mendor.

Duke qenë se në moshën 18 vjeçare arrihet pjekuria dhe fitohen një sërë të drejtash me ligj, siç është edhe e drejta e votës, duhet të ishte kjo mosha kur përfundon adoleshenca. Por faktet nuk tregojnë të njëjtën gjë. Për shumë individë periudha e përgatitjes për jetën si i rritur zgjatet edhe pas arritjes së pjekurisë ligjore e deri sa të arrijë pavarësinë financiare nga familja, kalojnë disa vite pas të njëzetave. Zakonisht pjekuria e plotë ndodh atëherë kur individ i shkëputet nga trangu familjar për të jetuar më vete. Në këtë aspekt dallohet ajo që quhet 'adoleshenca e zgjatur'. Studiuesit kanë rënë dakord në etiketimin 'rini' të fazës së jetës që qëndron midis adoleshencës dhe moshës së pjekur në kuptimin e plotë të saj. Adoleshenca ndahet në tre faza zhvillimi:

- ← para- adoleshenca (11- 14 vjeç);
- ← adoleshenca (15- 18 vjeç);
- ← adoleshenca e vonuar (19 e më pas).

Faza e parë karakterizohet nga ndryshimet e theksuara psikofizike, faza e dytë nga identifikimet që të rinjtë i bëjnë konfliktit të shprehur në nivele të ndryshme dhe faza e tretë nga konsolidimi i identitetit seksual dhe roleve gjinore e sociale (Palmonari, 2001). Me futjen në adoleshencë fëmija është në gjendje të arsyetojë rreth problemeve abstrakte dhe hipotetike që përfshijnë koordinimin e shumë faktorëve njëherazi. Sipas Piazhës ata ndodhen në fazën e operacioneve formale apo

abstrakte, e cila i ndihmon të jenë të aftë të përballojnë lëndët e shkollës 9- vjeçare e të mesme. Adolehentët karakterizohen nga përqendrimi në idetë e tyre edhe pse nuk e mohojnë se personat e tjerë mund të kenë ide dhe mendime të ndryshme (Woolfolk, 2011).

Hall e përshkruan adolehencën si një «lindje e re», pasi karakterizohet nga një rinovim total në të gjitha aspektet e personalitetit. Fëmijët, sipas tij, tërhiqen nga bota e jashtme dhe fenomenet e saj, ndërsa adolehentët orientohen mbi të gjitha të zhvillojnë një botë të brendshme që realizohet përmes një aftësie të përpunuar introspektimi dhe vetë eksplorimi. Për fëmijët, fenomenet e botës fizike kanë një vlerë për ta ose ndjellin interes për mënyrën se si verifikohen, ndërsa për adolehentin këto fenomene nuk janë gjë tjetër veçse simboli i një manifestimi i gjendjes shpirtërore dhe i ndjenjave, entuziazmit, trishtimit, mbylljes në vetvete, ëmbëlsisë, të jetuara në përditshmërinë e tyre. Për fëmijën realiteti ka kufij hapësinore e kohore pak a shumë të afërta, ndërsa për adolehentin këto kufij hapen, aq sa në disa momente e sipas disa perceptimeve, shkojnë deri në pafundësi. Ndërkohë që fëmijët mësojnë duke u nisur nga objektet, adolehentët fillojnë të arsyetojnë në bazë të thënieve verbale. Arrijmë kështu të përmbushin arsyetimet hipotetike – deduktive dhe të kuptojnë idenë e relativitetit. Veç të tjerave mësojnë të reflektojnë në mënyrë kritike mendimet e tyre. Kështu, adolehenti me kalimin e kohës aftësohet në përdorimin e mendimit abstrakt dhe e pasqyron jo vetëm botën familjare, shkollë, sociale e politike ashtu siç është, por edhe siç mund të jetë nëse disa elemente e disa kushte të ndryshojnë. Gjatë adolehencës një pjesë e mirë e energjisë së tyre harxhohet për hovin që pësojnë në rritjen fizike, kështu u mbetet më pak energji për ta shpenzuar në çështjet shkollë si (frekuentimi, studimi, marrëdhënia me mësuesit dhe moshatarët). Nëse merret në konsideratë që ndryshimi i klasave nga fillorja në 9- vjeçare është një burim stresi më vete, sepse përfshin nevojën për tu orientuar në një ambient të panjohur më parë, mund të bihet dakord me teorinë e akumulimit të ngjarjeve stresuese, sipas së cilës në adolehencën e hershme mund të jenë të pakta motivimet për performancë të mirë shkollë dhe për pranimin e rregullores së saj. Si rrjedhojë një rënie e mundshme e rendimentit shkollor nuk duhet dramatizuar (Hall, 1904).

Shkolla, padyshim është një nga institucionet ekstra familjare, të cilës shoqëria i ka besuar një nga detyrat më të rëndësishme për përgatitjen e të rinjve për jetën sociale. Adolehenca njihet si faza specifike e ekzistencë njerëzore, pasi është kjo moshë kur kanalizohen idetë dhe tiparet e socializimit të individit. Shkolla është padyshim një ambient thelbësor për socializimin e të rinjve, një ambient ku mësohet të ndërveprohet me të tjerët, duke përfutur shumicën e elementeve që i mundësojnë një të riu të bëhet protagonist i vërtetë në kontekstin kulturor ku ka lindur. Veçanërisht, nga fakti që ndjekin shkollën rrjedh edhe roli social i njohur unanimisht për ata që janë në moshën e adolehencës: roli i studentit. Ndër detyrat e zhvillimit me të vilat adolehentët duhet të përballen, ato në lidhje me shkollën duken të lidhura ngushtë me eksperiencat vetjake të sukseseve dhe dështimeve, faktor që ndikojnë mjaft në vetëbesimin dhe idenë për veten. Shumë situata të vështira në shkollë provokojnë ankth, tension, frikë. Frika e shkaktuar nga vështirësitë që duhen përballuar, qofshin këto reale apo për shumë vetëm imagjinare, mund t'i drejtojë individët që preken, ta shkarkojnë në aktivitete ekstra shkollë ku ata janë më të prirur si: një disiplinë sportive, muzikë, popullariteti ndër moshatarët, aftësia për tu dukur te moshatarët e seksit të kundërt... Arrijtjet personale në këto zgjedhje, i lejojnë që të ruajnë një nivel të lartë vetëvlerësimi dhe të kenë mendim të mirë për veten. Situata më e rëndë është ajo e individëve që bllokohen nga frika e vështirësive shkollë dhe nuk gjejnë alternativa ku të shkarkojnë energjitë e veta. Ata që mendojnë se të investosh në diçka nuk ka asnjë kuptim, bëhen komplet të demotivuar, ndonjëherë shkojnë deri në apati e depresion (Palmonari, 2001).

Autor të ndryshëm mbështesin idenë se është e rëndësishme që studentët të ndihen të lidhur/ të afërt me shkollën dhe të kenë marrëdhënie kuptimplota me të tjerët në ambientin shkollor. Këto marrëdhënie fillojnë me mësuesin në klasë. Kur këto marrëdhënie nuk vendosen, mundësia për të krijuar probleme rritet (Damiani, 2006). Në shkollë, gjatë detyrave të tyre shprehëse, nxënësit tregojnë për ndjenjat. Gjendjen e tyre emocionale, shqetësimet dhe të gjitha këto janë sinjale tepër të dukshme për mësuesit se si ndihen nxënësit, me kë kanë të bëjnë në momente të caktuara, në këtë mënyrë ata mund të ndërhyjnë duke u konsultuar më parë me specialist ose kolegët e tyre, për t'u ardhur në ndihmë nxënësve që shfaqin një shqetësim. Në këtë mënyrë shkolla luan një rol të rëndësishëm në identifikimin dhe parandalimin e konflikteve apo sjelljeve devijante që mund të lindin gjatë kohës së qëndrimit në shkollë apo edhe pas saj. “Mësuesit duhet ti ndihmojnë nxënësit ti shikojnë situatat më tepër si sfida sesa si kërcënime.” (Damiani, 2006).

Tekstet që trajtojnë teorinë e atashimit i caktojnë asaj meritat për shpjegimin dhe rregullimin e zhvillimit psikologjik dhe të marrëdhënive të individit, por edhe nga ndikimi i saj në fusha të tjera siç janë të nxënës, të kuptuarit dhe të bashkëpunuarit. Kjo lidhje bëhet pasi ecuria e këtyre fushave është tepër e lidhur me idenë për veten dhe besimin në aftësitë vetjake. Sipas Bowlby (1977) dhe pohimeve të hulumtuesve të tjerë, është vënë re se fëmijët e sigurt për mbështetjen dhe pranimin e prindërve, duken të aftë për të gjetur zgjidhje pozitive e konstruktive kur përballen me situata veçanërisht stresuese dhe problematike. Marrëdhëniet afektive do t'u mundësojnë atyre të përballojnë me sukses situatat sociale, konjitive dhe afektive të cilat kryesisht dalin në pah dhe zhvillohen në shkollë. Ambienti shkollor, si një vend socializues për fëmijët, u jep atyre mundësinë për të zgjeruar lidhjet sociale me moshatarët dhe nxjerr në pah nevoja të reja me të cilat ata duhet të përballen. Thelbi i teorisë së atashimit qëndron te koncepti i proceseve identifikuese që gjenerojnë siguri. Në këtë aspekt, mësuesi në shkollë ka një rëndësi të veçantë pasi mund të ndihmojë në nxitjen e këtyre proceseve identifikuese. Coleman në studimin e saj mbi ndjenjën e humbjes, vëren se fëmijët e klasave të katërta janë të aftë të përshkruajnë ndjenjat e tyre dhe beson se shkollat duhet t'u ofrojnë nxënësve të tyre më shumë se sa dijet që ato u mësojnë. Duhet t'u ofrojnë mësim shëndeti të cilat do të rezultojnë thelbësore për jetën e tyre. Përveç rolit që tashmë njohim, mësuesi mund të shndërrohet në një dëgjues dhe mbështetës për nevojat, ndjenjat e nxënësve e t'u ofrojë atyre mundësinë për t'u ndjerë më afër dhe të mund të gjejnë përgjigje për ato çka duan të dinë. Shkollat shndërrohen kështu në një ambient bashkëbisedues ku nxënësit mund të flasin lirshëm për shqetësimet që kanë dhe të gjejnë rrugëzgjidhje për to (Coleman, 2009).

Sipas St. Leger, është i rëndësishëm identifikimi i disa faktorëve, të cilët duhen marrë në konsideratë për të vlerësuar ndërhyrjet e programeve cilësore promovuese të shëndetit në shkolla. Koha, periudha e përshtatshme është një faktor shumë i rëndësishëm së bashku me intensitetin e ndërhyrjes dhe një program të formuluar mirë teorikisht (St Leger, 2006).

Eksperiencia shkollore ka një rëndësi të veçantë në strukturimin e kompetencave që vihen në përdorim në jetën publike. Klima e jetuar në klasë dhe në të njëjtin ambient shkollor kanë një impakt si në rendiment, si në qëndrime, ashtu edhe në mënyrën e sjelljes, jo vetëm në sistemin shkollor por edhe në institucione të tjera (Migani, 2004).

Bibliografia

- Ainsworth M.D.S., Bell S.M. (1970). Attachment, exploration, and separation: Illustrated by the behavior of one-year-olds in a strange situation. . *Child Development*, 41, 49-67.
- Ben-Arieh A., Goerge R.M. . (2006). *Indicators of Children's Well-being: understanding their role, usage, and policy influence*. Dordrecht: Springer.
- Bowlby J. (1944). Forty-Four Juvenile Thieves: Their Characters and Home Life. *International Journal of Psycho-Analysis*, 25:19-52,107-127.
- Bowlby, J. (1977). The Making and Breaking of Affectional Bonds. *Brit. J. Psychiat.*, 201-210.
- Brazelton T.B., Greenspan S.I. (2000). *The Irreducible needs of Children*. Cambridge: Perseus Publishing.
- Coleman J.B., Dendry L. (1997). *The Nature of Adolescence*. London: Routledge Press.
- Coleman, K. J. (2009). Learning about loss within a health education program. *Health Education, Vol. 109(1)*, 9-24.
- Damiani, V. B. (2006). *Crisis Prevention And Intervention in the Classroom: Everything Teachers Should Know*. Lanham MD: Rowman & Littlefield Pub.
- Durlak, J. A. (1995). School-based Prevention Programs for Children and Adolescence. *Thousand Oaks, SAGE*.
- Gentile S. (n.d.). <http://www.nostrofiglio.it/bambino/bambino-6-14-anni/scuola-primaria/64312-alla-scuola-dei-grandi-dalla-materna-alle-elementari>.
- Hall, G. S. (1904). *Adolescence: Its psychology and its relations to physiology, anthropology, sociology, sex, crime, religion, and education*. New York: D. Appleton & Co.
- Havighurst, R. J. (1953). *Human Development and Education*. New York: McKay.
- Leger, L. S. (2006). Improving the quality of school health evaluations. *Health Education, Vol. 106(4)*, 261-264.
- Migani, C. (2004). *Dal disagio scolastico alla promozione del benessere*. Roma: Carrocci.
- Palmonari, A. (2001). *Gli adolescenti*. Bologna: Il Mulino.
- Pianta, R. (2001). *La relazione bambino-insegnante. Aspetti evolutivi e clinici*. Milano: Raffaello Cortina.
- Steele H., Steele M., Croft C. (2008). Early attachment predicts emotion recognition at 6 and 11 years old. *Attachment & Human Development, Vol. 10(4)*, 379-393.
- Woolfolk, A. (2011). *Psikologji Edukimi*. Tiranë: CDE.

ALBANIAN TEACHERS' APPROACHES TO CLASSROOM MANAGEMENT

NIHAT AKSU

Universiteti Europian i Tiranës, Faculty of Social Sciences and Education, PhD Candidate

ABSTRACT

One of the key elements in having an effective teaching and learning atmosphere goes through classroom management. On the other hand, different needs brought different approaches and strategies to solve the broad area of classroom management. The 21st century classroom managements require quite complex approaches. In this article it is aimed to present strategies used by teachers in classroom management. The researcher anonymously surveyed 45 teachers who were teaching in private institute in Tirana were asked to complete the Incredible Years Teacher Strategies Questionnaire (TSQ) section A and section B only to measure classroom management behavior and the frequency of use of five teacher strategies: praise and effectiveness, proactive strategies, limit-setting, total positive approaches, and inappropriate strategies. The variables such as gender, years of experience, and age that may influence teachers' classroom management strategies and confidence are discussed. After analyzing the data, it was revealed that male and female teachers differ in terms of coaching, praise and incentives, proactive strategies, and social & emotional teaching strategies they employ. The results indicated that there was no relationship between years of experience and coaching, praise and incentives strategies and proactive strategies. Only there was a relationship between years of experience and social & emotional teaching strategies. However, they differed in terms of age, teachers in age group of 45-54 are better at coaching, praise and incentives, proactive strategies, and social & emotional teaching strategies. By analyzing the data, the results indicated that a solid half of the study's participants were not using positive classroom strategies and lack of these classroom management strategies were also causing use of inappropriate classroom management techniques.

Keywords: *classroom management, confident teacher, inner discipline, effective teaching*

Introduction

Students facing the teacher in a class, waiting for instructions, and being taught new subjects is quite a burden on teacher's shoulders as each individual requires different approaches to their inner worlds of comprehension. There are no two people in the world that have exactly same values of interest, or sharing same characteristic traits. Thus, motivating different people around the same purposes or set goals is quite a difficult task for instructors, educators, especially the ones that are willing to educate students for a better future in terms of a better university, and a better or satisfying job which requires a long term plan of diligent hard work. Literature, on the other hand, suggests that effective classroom managers take greater measures to prevent misbehavior from occurring (Emmer, Evertson, & Anderson, 1980) and that such measures should be emphasized before and during the first days of the school year (R. T. Wong & Wong, 1998), and (BROOME, 2013). Thus; if a measure is to be taken for classroom management it should be from the beginning and consistent in its application.

The followings are some of the headings that can be applied in order to reach a healthier classroom management: (1) Provide Appropriate Supervision, (2) Provide Appropriate Structure and Routines, (3) Model Appropriate Behavior, (4) Reinforce Appropriate Behavior, (5) Provide Predictable and Consistent Discipline, (6) Avoid Looking for Biological Causes of Behavior, (7) Be A Teacher, Not A Friend, (8) Let Students Know You Like Them & Are Interested In Their Interests, (9) Have Fun! (10) Be Consistent. Among the above mentioned techniques I would like to write in favor of the tenth approach as consistency would also cover the other techniques as it plays the most crucial role in classroom management.

Literature Review

Provide Appropriate Supervision

Students being observed throughout the lesson may indicate better performance, however the ones that are supervised even in their daily lives would perform much better performances in terms of being planned in terms of what to do, when to do, and how to do. "The students are secure in knowing what is going to happen every day" (H. Wong, Wong, Rogers, & Brooks, 2012) as to make sure students have their days planned and sure of being supervised; "There are procedures that help students organize their day" (H. Wong et al., 2012).

Provide Appropriate Structure and Routines

On daily basis, students need to know the things they have to do in completing their daily learning or knowledge gaining process. Teacher should provide some principles and routines that will help students avoid distraction. For example daily assignment checks should be done via check lists in an orderly fashion which will also help the teacher to have a reliable collected data on student's improvement. "• Create four to six classroom rules that clearly specify appropriate behavior • Consider Involving the students in the generation of the rules. • Write the rules using positive language. • Post and refer to classroom rules as necessary. • Develop routines to provide direction about how different classroom tasks are accomplished. • Teach and demonstrate classroom rules and routines as specifically as you do academic content." (Garrett, 2013)

Model Appropriate Behavior

Role modeling is also essential in having students reflect the expected behavior as their personality and characters get shaped by what they observe from their parents and teachers. Children turn into what we put in front of them; if they have good role models in front of them, and then they can manage to build strong characteristic traits. "Two independent characteristics of teacher behaviour can be used to map the teacher-student relationship: control and affiliation. As described in Wubbels, Brekelmans, den Brok, and van Tartwijk (2006)" (Wubbels, 2011).

Reinforce Appropriate Behavior

Reinforcing positive behavior is also an essential element in canalizing students' behavior into the positive learning. Students should see that their positive behavior is valued by the teacher so that he/she can reflect the same behavior when needed; otherwise the behavior would diminish throughout time. "One new direction gaining momentum is the application of a Positive Behavior Supports model in a multitier system of intervention" (Ihlo & Nantais, 2010). Promoting a prevention oriented positive environment involves universal supports found successful in the past (Roskos & Neuman, 2012).

Provide Predictable and Consistent Discipline

Teachers should provide predictable and consistent discipline. In order to gain trust and fairness among students, the rules and guidelines should be clear and perceivable. Once the rules are explained through rational reasons their consequences should also be given as to avoid misunderstandings on both student and teacher side.

Avoid Looking for Biological Causes of Behavior

When encountered with unwanted behavior, biological reasons such as tantrums behind the behavior shouldn't veil the real reason behind it. A good teacher should be able to see beyond the matters when needed. Sometimes normally well-mannered students may reflect negative behavior which could be given a logical explanation by the student when given the chance of expressing himself/herself.

Be A Teacher, Not A Friend

The relation between teacher and students shouldn't trespass the red lines which is quite vital in keeping the balance as it may cause loss of control and make the whole process of hard work going astray. On the other hand, it is important that a teacher keeps a good relation with his/her students.

Let Students Know You Like Them & Are Interested In Their Interests

While being able to keep the distance between the teacher and student, teacher should also be able to show his/her interest in students' hobbies or areas of fun. They might be able to make some little jokes to each other, and talk about things out of lesson. On the other hand, students' being in the same class with different backgrounds is itself a mixture as no two students are alike. Each individual has his/her own traits, especially when it comes to teaching where differences are to be lessened or at least blurred in order to emphasize unity and reach every person in the class. Thus, differences are to be reflected as variety of values.

Have Fun!

While trying on heavy burdens of teaching and learning processes both teachers and students may spare some time for fun, more importantly the lesson shouldn't be given in a very serious, mundane way as it would cause boredom. There can be little breaks of entertainment and lesson process should be provided together with fun, in other words, students should learn through funny activities.

Be Consistent

Among above mentioned techniques the most inclusive one that also covers the other techniques in a way is being consistent in whatever discipline, rules, or guidelines are being followed. If students are well aware of the fact that their teachers are following some principles persistently they will eventually start to indicate positive behavior no matter what obstacles they face during the process of educational year (Lewis, Newcomer, Kelk, & Powers, 2000). "Management procedures and routines that have been deliberately established in the first few weeks of school stabilize when teachers adhere to a small set of well-defined expectations (e.g., "Be respectful; be responsible; be a problem solver"), provide reinforcement when expectations are met, and swiftly apply stated consequences when they are not"(Roskos & Neuman, 2012).

Methodology

A. Research Questions

- ← To what extent are the classroom management strategies being employed by teachers?
- ← How do teachers' gender, age, and years of teaching experience influence their choice of classroom management strategies and confidence in classroom management situations?

← Participants

Participants of this study were composed of 45 teachers. Out of these 45 teachers, 20 were females and 25 were males. They were between 23 to 68 years old. These teachers were teaching in a private school in Tirana.

C. Instrument

Teacher Classroom Management Strategies Questionnaire (2012) created by The Incredible Years was utilized in this study. It is of reasonable length and should prove to be a useful tool for researchers interested in exploring the classroom management strategies of teacher.

There were 4 sections A, B, C and D. These sections were managing classroom behavior, specific teaching techniques, working with parents, and planning and support. There were 3 items in section A; items 1 (confident in managing current

behavior problems), 2 (confident in managing future behavior problems), and 3 (confident in emotional, social and problem solving teaching); and were offered on a 6-point Likert scale, ranging from: 1- very unconfident, to 6- very confident.

There were 38 items in section B and related to the five subscales and measure the frequency of use and the usefulness of five teacher strategies: coaching, praise and incentives, proactive strategies, social & emotional teaching strategies, limit-setting strategies, and inappropriate strategies.

Items 1 (coach positive social behaviors), 3 (frequency reward with incentives), 4 (frequency praise), 18 (frequency use group incentives), 19 (frequency use special privileges), 20 (frequency individual incentive programs), 31 (call parents to report good behavior), and 28 (send home happy grams about positive behavior) were measuring the coaching, praise and incentives. Items 15 (frequency use problem solving), 16 (frequency use anger management), 17 (frequency prepare for transitions), 21 (frequency clear positive directions), 23 (frequency clear classroom discipline plan), 24(emotion coaching), 26 (persistence coaching), and 29 (call child after a bad day) were measuring proactive strategies.

Items 32 (model self-regulation strategies for students), 33 (teach specific social skills in circle time), 34 (use imaginary play to teach problem solving), 35 (set up problem solving scenarios to practice pro social solutions), 36 (promote respect for cultural differences in classroom), 37 (teach children to ignore disruptive behavior), and 38 (teach children anger management strategies) were measuring social & emotional teaching strategies.

Items 5 (frequency use time out for destructive behavior), 13 (frequency ignore non-destructive misbehavior), 14 (frequency use verbal redirection for disengagement), 22 (frequency warn of consequences for misbehavior), and 25 (frequency nonverbal signals to redirect) were measuring limit-setting strategies.

Items 2 (frequency comment on bad behavior), 6 (frequency single out child or group for misbehavior), 7 (frequency use physical restraint), 8 (frequency use comments in loud voice), 9 (frequency in-house suspension), 10 (frequency warn to send child out of class), 11 (frequency send child home), 12 (frequency call parents report bad behavior), and 27 (frequency send home notes re problem behavior) were measuring inappropriate strategies. These 38 items were offered on a 5-point Likert scale, ranging from: 1- rarely/never, to 5- very often to measure the frequency of use and the usefulness.

There were 10 items in section C; items 1 (promote parent involvement), 2 (teach parenting skills), 3 (collaborate on behavior program), 4 (hold extra conferences for problems), 5 (involve parents in home activities with child), 6 (develop parent partnerships), 7 (send home teacher communication letters or newsletters), 8 (talk to parents/culture), 9 (home visits), and 10 (parent support groups). Section C items and in section B item 30 (student interest survey) were measuring frequency of use of positive approaches with parents. In section D 8 items were measuring planning and support related strategies. Section C and D items were offered on a 6-point Likert scale, ranging from: 1-never, to 7-daily. The reliabilities of the scales of classroom management strategies for the present study follow: 0.81 for managing classroom behavior and 0.70 for specific teaching techniques.

Procedure

Teachers completed the Incredible Years Teacher Strategies Questionnaire (TSQ) section A and section B only to measure classroom management behavior and the frequency of use and the usefulness of five teacher strategies: praise and effectiveness, proactive strategies, limit-setting, total positive approaches, and inappropriate strategies.

Results and Discussion

Forty-five teachers anonymously completed the questionnaire and all analyses for the study were done with SPSS 20. The first three questions asked participants general information about themselves. The first question asks gender. Of the forty-five participants, 25 were male and 20 were female. The second question asks age of participants. Of the forty-five participants 25 were between ages 20 and 34, 11 were between ages 35 and 44, 3 were between ages 45 and 54, and 6 were ages 55 or above. The third question asks years of teaching experience. Of the forty-five participants, 14 have 5 or less years, 12 have between 6 and 10 years, 7 have between 11 and 15 years, 3 have between 16 and 20 years, and 9 have 21 or more years of teaching experience.

The section A uses a 6-point scale rating. Participants were asked if they “unconfident”, “somewhat unconfident”, are “neutral”, “somewhat confident”, “confident” or “very confident” to three separate statements focusing on confidence in classroom management situations such as confident in managing current behavior problems, confident in managing future behavior problems and confident in emotional, social and problem solving teaching. The highest response was “confident” with 58.5%. The second highest response chosen was “very confident” with a much lower percentage of 16.3%. Male and female teachers differ in terms of managing classroom with confidence. In terms of participants’ gender the highest response “confident” was chosen by male teachers are 65.3% and by female teachers are 50.0%. However, the “unconfident” response was chosen by male teachers with 4.0%. In terms of participants’ age and years of teaching experience the most frequently chosen response was “confident”. But it decreased significantly and response “very confident” increased with increase of age and years of experience. By analyzing the responses percentages are combined, “often” and “very often”, it can be assumed that there was positive correlation between years of experience, age and confidence. In terms of gender, age, and years of teaching experience, the Table 1 shows percentages and totals are based on responses to a group of three statements on confidence in classroom management situations.

TABLE 1 COMPARISONS FOR GENDER, AGE, AND TEACHING EXPERIENCE AND CONFIDENCE SCALE

Unconfident			Confidence Managing Classroom ^a					
			Neutral	Somewhat confident	Confident	Very confident		
Somewhat unconfident								
Gender	Male	25	4.0%	4.0%	2.7%	8.0%	65.3%	16,0%
	Female	20	0.0%	3.3%	15.0%	15.0%	50.0%	16,7%
Age	20-34	25	4.0%	6.7%	6.7%	12.0%	61.3%	9,3%
	35-44	11	0.0%	0.0%	12.1%	12.1%	66.7%	9,1%
	45-54	3	0.0%	0.0%	0.0%	22.2%	44.4%	33,3%
	55+	6	0.0%	0.0%	11.1%	0.0%	38.9%	50,0%
Teaching Ex- perience	0-5	14	0.0%	11.9%	9.5%	9.5%	57.1%	11,9%
	6-10	12	8.3%	0.0%	5.6%	22.2%	52.8%	11,1%
	11-15	7	0.0%	0.0%	9.5%	14.3%	76.2%	0,0%
	16-20	3	0.0%	0.0%	11.1%	0.0%	66.7%	22,2%
	21+	9	0.0%	0.0%	7.4%	0.0%	51.9%	40,7%
Total		45	2,2%	3.7%	8.2%	11.1%	58.5%	16.3%
Percentages and totals are based on respondents.								
a. Group								

The section B were focusing on how often teachers use the specific teaching and classroom management techniques. This section has five scales for frequency; coaching, praise and incentives; proactive strategies; social & emotional teaching strategies; limit-setting strategies; inappropriate strategies. Total positive strategies include items in the first three scales.

The scale coaching, praise and incentives includes eight separate statements such as reward targeted positive behaviors with incentives (e.g. stickers) and praise positive behavior. The Table 2 shows that the highest response was “often” with 29.3%. However, the second highest response chosen was “sometimes” with a slightly lower percentage of 28.1%. The response of “rarely/ never” was 14.1% which is almost half of highest response. The scale proactive strategies include eight separate statements such as use problem-solving strategy (e.g., define problem, brainstorm solutions) and use anger management strategy for self (e.g., deep breaths, positive self-talk). The highest response was “often” with 28.1% and other selected responses were closed to the each other. Other responses for group of proactive strategies statements were “rarely/never” with 18.5%, “sometimes” with 20.0%, “half of time” with 16.3%, and “very often” with 17.0%. The scale social & emotional teaching strategies include seven separate statements such as set up problem solving scenarios to practice pro-social solutions and teach children to ignore disruptive behavior. The Table 2 shows that the highest response was “often” with 31.9%. However, the second highest response chosen was “sometimes” with a slightly lower percentage of 30.4%. The scale limit-setting strategies include five separate statements such as use time out (time away to calm down) for aggressive behavior and use verbal redirection for child who is disengaged. The Table 2 shows that the highest response was “sometimes” with 33.3%. However, the second highest response chosen was “often” with a slightly lower percentage of 28.9%. The scale inappropriate strategies include nine separate statements such as use physical restraint and reprimand in a loud voice. The Table 2 shows that the highest response was “rarely/never” with 45.4%. However, the second highest response chosen was “sometimes” with percentage of 36.8%. It is significant that majority of participants were not using inappropriate strategies with an 82.2% of response (together with “rarely/never” and “sometimes”).

TABLE 2 MANAGEMENT STRATEGIES SCALES AND PERCENTAGES OF RESPONDENTS

Management Strategies Frequencies					
	Rarely/Never	Sometimes	Half the time	Often	Very Often
Coaching, Praise and Incentives ^a	14.1%	28.1%	10.4%	29.3%	18.1%
Proactive Strategies ^a	18.5%	20.0%	16.3%	28.1%	17.0%
Social & Emotional Teaching Strategies ^a	13.3%	30.4%	13.3%	31.9%	11.1%
Limit-Setting Strategies ^a	10.7%	33.3%	14.2%	28.9%	12.9%
Inappropriate Strategies ^a	45.4%	36.8%	6.7%	8.6%	2.5%
Percentages are based on respondents.					
a. Group					

Table 3 shows that in terms of gender male teachers more often were using coaching, praise and incentives strategies with 32.7% compare to female teachers with 11.2%. Female teachers' highest response was "sometimes" with 30.8%. Both male and female teachers chosen highest response were "often" with respectively 26.7% and 30.0%. Female teachers more often were using social & emotional teaching strategies with 38.3% compare to male teachers with 14.8%. Male teachers' highest response was "sometimes" with 30.7%. Male teachers more often were using limit-setting strategies with 32.0% compare to female teachers with 25.0%. Female teachers' highest response was "sometimes" with 39.0%. Female and male teachers answered "rarely/never" to the inappropriate strategies statements with respectively 44.0% and 47.2%. Male and female teachers differ in terms of coaching, praise and incentives, proactive strategies, and social & emotional teaching strategies they employ. According to the Table 3, male teachers are better at coaching, praise and incentives and proactive strategies, however female teachers are better at social & emotional teaching strategies.

TABLE 3 COMPARISONS FOR GENDER AND MANAGEMENT STRATEGIES SCALES

			Coaching, Praise and Incentives				
			Rarely/Never	Sometimes	Half the time	Often	Very Often
Gender	Male	25	11.3%	26.0%	10.0%	32.7%	20,0%
	Female	20	17.5%	30.8%	10.8%	25.0%	15,8%
Total		45	14,1%	28.1%	10.4%	29.3%	18.1%
			Proactive Strategies				
Gender	Male	25	14.7%	24.0%	12.0%	26.7%	22,7%
	Female	20	23.3%	15.0%	21.7%	30.0%	10,0%
Total		45	18.6%	20.0%	16.3%	28.1%	17.0%
			Social & Emotional Teaching Strategies				
Gender	Male	25	9.3%	30.7%	21.3%	26.7%	12,0%
	Female	20	18.3%	30.0%	3.3%	38.3%	10,0%
Total		45	13,3%	30.4%	13.3%	31.9%	11.1%
			Limit-Setting Strategies				
Gender	Male	25	9.6%	28.8%	14.4%	32.0%	15,2%
	Female	20	12.0%	39.0%	14.0%	25.0%	10,0%
Total		45	10,7%	33.3%	14.2%	28.9%	12.9%
			Inappropriate Strategies				
Gender	Male	25	44.0%	38.5%	6.5%	7.5%	3,5%
	Female	20	47.2%	34.6%	6.9%	10.1%	1,3%
Total		45	45,4%	36.8%	6.7%	8.6%	2.5%
Percentages and totals are based on respondents.							
a. Group							

The Table 4 shows total response percentages "often" and "very often" between classroom management strategies scales and participants' age. The total response percentages "often" and "very often" for coaching, praise and incentives strategies were highest in age group of 45-54 with 72.2% and lowest in age group of 55 and over with 41.7%. The total response percentages "often" and "very often" for social & emotional teaching strategies were higher in age groups of 45-54 (7.8%) and 55+ (72.2%) and lower in age groups of 20-34 (36.0%) and 35-44 (33.3%). The total response percentages "often" and "very often" for proactive strategies were 40.0% (20-34), 54.5 % (35-44), 55.6 % (45-54), and 44.4 % (55+). Table 4 data shows that below 34 aged teachers (11.5%) and 55 and above aged teachers (16.7%) were using inappropriate strategies in the classroom comparing to the middle aged (35-54) teachers (totally 10.3%). According to the Table 4, teachers in age group of 45-54 are better at coaching, praise and incentives, proactive strategies, and social & emotional teaching strategies.

TABLE 4 COMPARISONS FOR AGE AND MANAGEMENT STRATEGIES SCALES

	Age				Total
	20-34	35-44	45-54	55+	
*Coaching, Praise and Incentives _a	47.3%	43.9%	72.2%	41.7%	47.4%

*Proactive Strategies _a	40.0%	54.5%	55.6%	44.4%	45.2%
*Social & Emotional Teaching Strategies _a	36.0%	33.3%	77.8%	72.2%	43.0%
Limit-Setting Strategies _a	40.8%	50.9%	46.7%	26.7%	41.8%
Inappropriate Strategies _a	11.5%	10.3%	0.0%	16.7%	11.1%
Percentages and totals are based on total responses of „often“ and „very often“.					
a. Group, * positive management strategies					

The scale, “coaching, praise and incentives”, provided an interesting result since nineteen of the forty five participants who had years of teaching experience 6-10 and 11-15 chose “rarely/never” (16.7% and 21.4%) which were quite high response, while fourteen of them who had years of teaching experience 0-5 chose “rarely/never” (9.5%) but were having second highest response of “sometimes” with 31.0%. If the percentages of responses “often” and “very often” are combined for proactive strategies, participants who had years of teaching experience 6-10 chose highest response with 61.1%. Nine of the forty five participants who had years of teaching experience 21 or over not only chose highest response of “rarely/never” with 29.6%, but also chose highest response of “often” with 44.4% for the proactive strategies scale. The scale, “social & emotional teaching strategies”, also provided an interesting result, if the percentages are combined, “often” and “very often” make up 66.7% of the participants’ (21+) responses. Above 16 years experience had participants’ selected responses of “often” for inappropriate strategies were high with percentages of 12.5% and 11.1% compare to the less years of experience had participants with percentages of 8.9%, 6.3%, and 7.3%. In terms of participants’ “often” and “very often” response percentages were highest for coaching, praise and incentives strategies with 61.2% (16-20), were highest with 61.1% (6-10) for proactive strategies, and were highest with 66.7% (21+) for social & emotional teaching strategies. By analyzing the responses percentages are combined, “often” and “very often”, it can be assumed that there was no positive correlation between years of experience and coaching, praise and incentives strategies and proactive strategies. Only there was a positive correlation between years of experience and social & emotional teaching strategies. This analysis is illustrated in Table 5 below.

TABLE 5 COMPARISONS FOR TEACHING EXPERIENCE AND MANAGEMENT STRATEGIES SCALES

		Coaching, Praise and Incentives						
		Rarely/ Never	Sometimes	Half the time	Often	Very Often		
Teaching Experience	0-5	14	9.5%		31.0%	15.5%	29.8%	14.3%
	6-10	12	16.7%		20.8%	9.7%	27.8%	25.0%
	6-10	12		16.7%	20.8%	9.7%	27.8%	25.0%
	11-15	7		21.4%	21.4%	11.9%	31.0%	14.3%
	16-20	3		11.1%	16.7%	11.1%	55.6%	5.6%
	21+	9		13.0%	42.6%	1.9%	20.4%	22.2%
Total		45		14.1%	28.1%	10.4%	29.3%	18.1%
		Proactive Strategies						
Teaching Experience	0-5	14		19.0%	19.0%	26.2%	23.8%	11.9%
	6-10	12		11.1%	19.4%	8.3%	27.8%	33.3%
	11-15	7		14.3%	28.6%	19.0%	14.3%	23.8%
	16-20	3		22.2%	22.2%	22.2%	33.3%	0.0%
	21+	9		29.6%	14.8%	7.4%	44.4%	3.7%
Total		45		18.5%	20.0%	16.3%	28.1%	17.0%
		Social & Emotional Teaching Strategies						
Teaching Experience	0-5	14		9.5%	33.3%	14.3%	35.7%	7.1%
	6-10	12		16.7%	36.1%	16.7%	13.9%	16.7%
	11-15	7		14.3%	28.6%	23.8%	23.8%	9.5%
	16-20	3		11.1%	33.3%	11.1%	44.4%	0.0%
	21+	9		14.8%	18.5%	0.0%	51.9%	14.8%
Total		45		13.3%	30.4%	13.3%	31.9%	11.1%
		Limit-Setting Strategies						

Teaching Experience	0-5	14	11.4%	35.7%	8.6%	30.0%	14.3%
	6-10	12	10.0%	25.0%	21.7%	28.3%	15.0%
	11-15	7	8.6%	28.6%	20.0%	25.7%	17.1%
	16-20	3	20.0%	13.3%	26.7%	33.3%	6.7%
	21+	9	8.9%	51.1%	4.4%	28.9%	6.7%
Total		45	10,7%	33.3%	14.2%	28.9%	12.9%
			Inappropriate Strategies				
Teaching Experience	0-5	14	42.9%	36.6%	8.0%	8.9%	3.6%
	6-10	12	45.8%	40.6%	5.2%	6.3%	2.1%
	11-15	7	52.7%	27.3%	12.7%	7.3%	0.0%
	16-20	3	45.8%	33.3%	8.3%	12.5%	0.0%
	21+	9	43.1%	40.3%	1.4%	11.1%	4.2%
Total		45	45,4%	36.8%	6.7%	8.6%	2.5%
Percentages and totals are based on respondents.							
a. Group							

There were totally 540 responses to the positive strategies statements. Only 247 responses were “often” and “very often” which is less than half responses with 45.7%. And also used inappropriate strategies were quite high with 17.8%. By analyzing the percentages, it can be assumed that a solid half of the study’s participants were not using positive classroom strategies and lack of these management strategies were also causing use of inappropriate classroom management techniques. This analysis is illustrated in table 6 below.

TABLE 6 CLASSROOM MANAGEMENT STRATEGIES SCALES AND RESPONSES & PERCENTAGES

Classroom Management Strategies Scales	Responses „often“ & „very often“	
	N (1124)	Percent
Positive Strategies*	247 (540)	45.7%
Inappropriate Strategies	40 (225)	17.8%
Limit-Setting Strategies	94 (359)	26.2%
*Coaching, Praise and Incentives; Proactive Strategies; Social & Emotional Teaching Strategies		

Conclusion

The search for unknown throughout history brought us to the interrelation between school, teacher, and students; as it has always been a need for human beings to quench their thirst for learning more and more. However, environmental issues, different talents, variety of the goals, methodologies used in teaching or learning, and most importantly technology are some of the factors that determine the level of teaching and learning on each individual. Thus providing sustainable, maintainable principles and following them in order to achieve success is quite vital on both teacher and student side. Overall, this study sought to highlight the importance of classroom management, and shed light on how this influences teachers’ confidence and preparedness in the classroom.

References

- BROOME, J. L. (2013). *A Case Study in Classroom Management and School Involvement: Designing an Art Room for Effective Learning* (J. L. j. f. e. Broome, Trans. Vol. 66).
- Emmer, E. T., Evertson, C. M., & Anderson, L. M. (1980). Effective classroom management at the beginning of the school year. *The elementary school journal*, 219-231.
- Garrett, T. (2013). CLASSROOM MANAGEMENT: It’s More Than a Bag of Tricks. [Article]. *Education Digest*, 78(9), 45-49. Ihlo, T., & Nantais, M. (2010). Evidence-based interventions within a multi-tier framework for positive behavioral supports. *The promise of response to intervention: Evaluating science and practice*, 239-266.
- Lewis, T., Newcomer, L., Kelk, M., & Powers, L. (2000). Preventing and addressing aggressive and violent behavior through individual systems of positive behavioral support. *Reaching Today’s Youth*, 5, 37-41.
- Roskos, K., & Neuman, S. B. (2012). Classroom management for achieving readers. *The Reading Teacher*, 65(5), 308-312.
- Wong, H., Wong, R., Rogers, K., & Brooks, A. (2012). Managing Your Classroom for Success. *Science and Children*, 49(9), 60-64.

- Wong, R. T., & Wong, H. K. (1998). *The first days of school: how to be an effective teacher 2nd ed.* United States of America: Harry K. Wong Publications.
- Wubbels, T. (2011). An international perspective on classroom management: what should prospective teachers learn? *Teaching Education, 22*(2), 113-131.
- Wubbels, T., Brekelmans, M., den Brok, P., & van Tartwijk, J. (2006). An interpersonal perspective on classroom management in secondary classrooms in the Netherlands. *Handbook of classroom management: Research, practice, and contemporary issues*, 1161-1191.
- Years, T. I. (2012). Teacher Strategies Questionnaire, from [http://incredibleyears.com/download/resources/teacher-pgrm/ American%20Teacher%20Strategies%20Questionnaire.pdf](http://incredibleyears.com/download/resources/teacher-pgrm/American%20Teacher%20Strategies%20Questionnaire.pdf)

PËRGGJIGJA NDAJ SHQETËSIMIT TË PRINDËRVE: A LIDHET AUTIZMI ME VAKSINËN MMR?

Review e rezultateve të studimeve epidemiologjike

VOLTISA LAMA, PHD

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Psikologji.

Corresponding author E-mail: voltisa.lama@uet.edu.al

Voltisa Lama, PhD Formim klinik dhe licencim si specialiste në fushën e shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve. Fokusi si lektore dhe interesat kërkimore janë në Psikologjinë e zhvillimit dhe Psikopatologjinë e fëmijërisë dhe adoleshencës. Pozicioni aktual: Pedagoge në Universitetin Europian të Tiranës, Departamenti i Edukimit – dega Psikologji; Psikiatre për fëmijë & adoleshentë (konsulente në shërbim privat)

ABSTRAKT

Qëllimi i studimit: Shqetësimet për sigurinë e vaksinave, sidomos të vaksinës MMR (fruth-shyta-rubeolë) për të cilën prindërit kanë dëgjuar që është e lidhur me autizmin, i kanë shtyrë disa prindër në Shqipëri që të vonojnë apo mos ta kryejnë vaksinimin e fëmijëve të tyre. Ky punim ka për qëllim të sjellë review të literaturës lidhur me sigurinë e kësaj vaccine, për të komunikuar me evidenca shkencore praninë apo mungesën e lidhjes shkakore midis vaksinës MMR dhe shfaqjes së autizmit.

Metoda: Pyetja kërkimore që ngrihet është: A shkakton vaksina MMR autizëm? Duke përdorur fjalët kyçe u kërkua në database Pub Med dhe u identifikuan studime të lidhura me vaksinën MMR (measle mumps rubella) dhe autizmin përgjatë 17 viteve të fundit. Rezultatet: Kriteret e përfshirjes i përmbushën 18 artikuj. Asnjë nga studimet nuk gjeti lidhje midis vaksinës MMR dhe autizmit.

Konkluzioni: Bazuar në të dhënat e literaturës aktuale konkludoj se vaksinimi me MMR nuk shkakton autizëm. Për pasojë moskryerja e vaksinimit që i atribuohet një shaktari hipotetik i cili nuk ka mbështetjen shkencore aktuale, sjell risqe të tjera në shëndetin publik.

Fjalë kyç: *autizëm, vaksina MMR, lidhje, prindër, review e literaturës, studime epidemiologjike*

Hyrje

Autizmi është çrregullim i neurozhvillimit që karakterizohet nga deficite në bashkëveprimin social, komunikimin social si edhe modele të kufizuara, përsëritëse të sjelljeve, interesave apo aktiviteteve (DSM-V, 2013). Heritabiliteti i autizmit vlerësohet 90% në studimet me binjakë dhe pjesa më e madhe e rasteve janë poligjenike, dmth ekzistojnë me qindra lokuse të geneve që japin secila kontribute relativisht të vogla. DSM-V njih gjithashtu rëndësinë e faktorëve ambientale të cilët mund të kontribuojnë në riskun e çrregullimeve të spektrit autik (ASD) me termin “faktorë risku të shumëllojshëm jo specifik”. Një formë shumë e rrallë ndodh atëherë kur fëmija zhvillohet normalisht deri në moshën 1-2 vjeç dhe më pas paraqet përkeqësim në sjelljen sociale dhe aftësitë gjuhësore.

Vaksina fruth-shyta-rubeolë (MMR) u fut në përdorim në vitin 1998 në Angli (sipas Fombone & Chakrabarti, 2001, citimi origjinal Fine 1993). Hipoteza se vakcina MMR mund të shkaktojë autizëm erdhi nga një studiu britanik i quajtur Andrew Wakefield. Në revistën *The Lancet* në vitin 1998, ai raportoi historitë e 12 fëmijëve, tetë prej të cilëve zhvilluan shpejt pas marrjes së vaksinës MMR (fruth-shyta-rubeolë) probleme të zorrëve të pasuara nga problematika të sjelljes që u diagnostikuan klinikisht si autizëm. Ky publikim (Wakefield et al, 1998) shfaqti hipotezën që po krijohej një variant i çrregullimeve të spektrit të autizmit me regres në zhvillimin e fëmijës i cili lidhej me vaksinën MMR. Pavarësisht kritikave në disa studime pasuese sidomos për metodologjinë e ndjekur, dyshimi i Wakefield krijoi shqetësim publik në gjithë opinionin botëror që rezistoi në kohë. Hipoteza derivuese e së parës ishte ajo se ky variant i autizmit shpjegon rritjen e incidencës së autizmit përgjatë viteve. Hipoteza të tjera të lidhura me temën e shkakut të shfaqjes së autizmit janë: “autizmi shkaktohet nga timerosali”, një substancë konservuese e përdorur te vaksinat për të parandaluar kontaminimin e tyre, e cila ka merkur në përbërje apo “autizmi vjen nga fakti se fëmijët mbingarkohen me një numër më të madh vaksinash krahasuar me vite më parë në moshë të vogël”. Si hipoteza e timerosalit dhe e mbingarkesës me vakcina kanë ndeshur kritika nga komuniteti shkencor. Timerosali u hoq nga vaksinat si masë paraprake dhe që me heqjen e tij u kryen studime krahasuese, por risku i autizmit rezultoi i njëjtë si në grupin që kishte marrë vakcina me timerosal edhe në grupin e vaksinuar me vakcina pa timerosal. Përsa i përket hipotezës së mbingarkesës me vakcina theksohet se para licencimit kur një vaksinë e re ekzistuese i shtohet skedës ekzistuese të vaksinimit kryhen studime të përdorimit të njëkohshëm (concomitant use studies). Gjithashtu edhe pse numri i vaksinave është rritur përgjatë shekullit, numri i komponentëve imunologjikë është pakësuar (Vaccine Education Center CHOP, 2012). Duhet pasur parasysh se sfida imunologjike nga vaksinat është e vogël krahasuar me atë të mjedisit me të cilin fëmijët ndeshen çdo ditë të jetës që nga lindja. Dy hipotezat e lidhura me timerosalin dhe me numrin e konsiderueshëm të vaksinave në skedat e reja të vaksinimit të fëmijëve nuk do të jenë fokus i shqyrtimit të rezultateve të literaturës në këtë punim. Punimi ndalet tek lidhja midis vaksinës fruth-shyta-rubeolë (MMR) dhe autizmit.

Perceptimi se fëmija mund të shfaqë autizëm pas vaksinimit me vaksinën e fruth-shyta-rubeolë (MMR) vazhdon ende në vendin tonë bazuar në bisedat me prindër që ka zhvilluar autorja e këtij shkrimi gjatë konsultave si psikiatre për fëmijë, si edhe raportimit nga mjekët e konsultoreve. Në vendin tonë vakcina MMR programohet në skedën e vaksinimit në moshën 12 muajsh dhe rivaksinimi në moshën 5 vjeç. Mjekja e konsultorit të poliklinikës nr. 3 në Tiranë tregon se nga 427 fëmijë të regjistruar në prill 2014- prill 2015 të cilët sapo kanë mbushur moshën 1 vjeç të vaksinimit, për 35 prej tyre prindërit kanë refuzuar kryerjen e vaksinës MMR deri në këtë moment. Raportohen vetëm refuzimet, pasi edhe nga ata që e vonojnë kryerjen në kohën e programuar mund të ketë përsëri një pjesë refuzimesh. Numri i refuzimeve perceptohet nga mjekët edhe më i madh se kjo shifër, e cila nuk përfshin gjithë fëmijët banues në Tiranë, pasi ata janë të shpërndarë në konsultoret e çdo poliklinike. Perceptimi i prindërve përforcohet edhe nga fakti i lidhjes kohore, pasi vakcina MMR programohet në skedën e vaksinimit të shumicës prej vendeve midis moshave 12 dhe 15 muajsh dhe sjellja e fëmijëve me çrregullime të spektrit autik bie në mënyrë tipike në vëmendjen e prindërve rreth vitit të dytë të jetës 12-24 muajsh (DSM-V, 2013). De Stefano et al. në një studim në Atlanta, USA në vitin 2004 nxorën si rezultat se afro 70% e fëmijëve ishin vaksinuar me MMR midis moshave 12-17 muajsh. Për të testuar saktësinë e hipotezës së lidhjes shkakore mes vaksinës MMR dhe shfaqjes së autizmit, hulumtuesit në vende të ndryshme kanë kryer një seri investigimesh epidemiologjike, të cilat janë fokusi i këtij artikulli.

Qëllimi i studimit

Shqetësimet për sigurinë e vaksinave, sidomos të vaksinës MMR (fruth-shyta-rubeolë) për të cilën prindërit kanë dëgjuar që është e lidhur me autizmin, i kanë bërë disa prindër në Shqipëri që të vonojnë apo mos ta kryejnë vaksinimin e fëmijëve të tyre. Ky studim ka për qëllim të sjellë review të literaturës lidhur me sigurinë e vaksinës MMR, për të komunikuar me evidenca shkencore mungesën apo praninë e lidhjes shkakore midis vaksinave dhe shfaqjes së autizmit. Hipotezat e tjera për shfaqjen e autizmit si “mbingarkesa me vakcina” apo “përdorimi i timerosal” te vaksinat në përgjithësi nuk janë fokus i këtij artikulli.

Metoda

Pyetja kërkimore që ngrihet është: A shkakton vakcina MMR autizëm? Duke përdorur fjalët kyçe u kërkua në database Pub Med dhe u identifikuan studime të lidhura me vaksinën MMR (measle mumps rubella) dhe autizmin të botuara përgjatë periudhës 1998-2015. Kërkimi dhe shqyrtimi i artikujve zgjati 6 muaj (nëntor 2014-prill 2015) dhe u realizua nga autorja e

këtij shkrimi. U arkivuan 30 artikuj në gjuhën angleze të cilët lidheshin me temën e autizmit dhe vaksinave. 12 studimet të cilat lidheshin me komponentët e vaksinave në tërësi si timerosali, merkuri dhe asociimin e këtyre elementëve me autizmin (Uno et al, 2015; Andrews et al, 2004; Heron dhe Golding 2004; Hviid et al, 2003; Madsen et al, 2003; Picciotto et al, 2010; Price et al, 2010; Schechter et al, 2008; Stehr-Green et al, 2003; Tozzi et al, 2009; Verstraeten et al, 2003; Mrozek-Budzyn D et al, 2012) nuk u përfshinë në shqyrtim. U studiuan vetëm 18 artikuj të cilët fokusoheshin te objektivi kërkimor, pra lidhja midis vaksinës MMR dhe autizmit. Kampionët e studiuar ishin fëmijë nga vende të ndryshme: USA, UK, Danimarkë, Japoni, Poloni, Finlandë. Nga artikujt u nxorën të dhënat që lidheshin me metodologjinë e studimit, kampionin, rezultatet të cilat do të konfirmenin apo hidhnin poshtë lidhjen midis autizmit dhe vaksinës MMR (tabela 1 jep një përmbledhje të tyre).

Rezultatet

Kriteret e përfshirjes i përmbushën 18 artikuj, pjesa më e madhe e tyre (15) studime origjinale, një artikull përfshihej tek rubrika e komenteve (Fombone and Cook, 2003), 2 artikuj ishin review e literaturës (Fombone and Cook, 2003; Maglione dhe bp., 2014). Për sa i përket metodologjisë mbizotëronin studimet case-control dhe kohore. Asnjë nga studimet përveç atij të Wakefield i cili ngriti këtë hipotezë nuk provoi lidhjen shkakore midis vaksinës MMR dhe autizmit. Review-të e Wilson dhe bp., 2003 dhe Maglione dhe bp., 2014 gjithashtu hedhin poshtë lidhjen midis vaksinës MMR dhe autizmit, megjithatë Wilson dhe bp. shprehen me rezervë për të përjashtuar totalisht lidhjen midis një varianti të rrallë të ASD (variant i rrallë me regres, jo format e zakonshme të autizmit) dhe vaksinës MMR duke gjykuar se deri në atë kohë ekzistonin pak prova epidemiologjike.

TAB 1. PASQYRA E STUDIMEVE CASE-CONTROL ME FOKUS VAKSINËN MMR & AUTIZMIN

Burimi	Vendi	Kampioni	Revista	Analiza	Rezultati
Uno et al, 2012	Japoni	189 adultë në moshë të re me ASD & 224 subjekte në grupin e kontrollit	Vaccine	Case-control study	Mungon lidhja midis vaksinimit me MMR & shtimit të rasteve me autizëm
DeStefano et al, 2004	USA	624 fëmijë në grupin me autizëm (93.4% e tyre të vaksinuar me MMR) & 1824 fëmijë në grupin e kontrollit (90.6% e tyre të vaksinuar me MMR) të përputhshëm për moshën, gjininë dhe shkollën	Pediatrics	Case-control study. Krahasim i moshës kur janë vaksinuar me MMR	Shpërndarje e ngjashme në moshën e vaksinimit me MMR midis grupit me autizëm & grupit të kontrollit, shumica në secilin nga grupet të vaksinuar në moshat 12-17 muajsh
Smeeth et al, 2004	UK	1294 raste me PDD lindur pas vitit 1973 & 4469 fëmijë në grup kontrolli. Burimi database GPRD	The Lancet	Case-control study	Mungon lidhja midis vaksinimit me MMR & shtimit të riskut për PDD
Davis et al, 2001	USA	155 persona me sëmundje inflamatore të zorrëve, të lindur në vitet 1958-1989	Arch Pediatr Adolesc Med.	Case-control study	Risku për sëmundje inflamatore të zorrëve nuk ndryshonte midis fëmijëve të vaksinuar me MMR & të pa vaksinuar
Wakefield et al, 1998	UK	12 fëmijë me moshë mesatare 6 vjeç, 11 prej tyre djem të referuar në repartin e gastroenterologjisë	The Lancet	Case -study	Shfaqja e simptomave të sjelljes lidhet me marrjen e vaksinës MMR në 8 raste

Shkurtime: ASD - Autism Spectrum Disorder, Çrregullim i spektrit autik

PDD - Pervasive Development Disorder, Çrregullim që prek fushat e zhvillimit

TAB 2. PASQYRA E STUDIMEVE ANALIZË E TRENDIT NË KOHË (TIME SERIES) ME FOKUS VAKSINËN MMR & AUTIZMIN

Burimi	Vendi	Kampioni	Revista	Analiza	Rezultati
Dales et al, 2001	USA	Kaliforni: fëmijët e kopshteve të lindur në vitet 1980-1994 (mostra e survey 600-900 fëmijë çdo vit).	Journal of American Medical Association	Survey. Analizë retrospektive e përqindjeve të vaksinimit të fëmijët. U përcaktua moshë në të cilën ata u vaksinuan & rastet me autizëm të fëmijëve të lindur në ato vite	Mungon lidhja midis vaksinimit me MMR dhe shtimit të rasteve me autizëm

Farrington et al, 2001	UK	357 fëmijë me autizëm	Vaccine	Analizë e pavarur e studimit të mëparshëm të Taylor et al. 1999 për të testuar një hipotezë të modifikuar	Nuk ekziston lidhje shkakore MMR-autizëm
Kaye et al, 2001	UK	Kohorte konsekuative të fëmijëve të diagnostikuar me autizëm përgjatë 12 viteve (1988-1999). Burimi database GPRD	British Medical Journal	Matje e incidencës vjetore të autizmit në moshën kur u diagnostikua për herë të parë për të studiuar lidhjen kohore të vaksinës MMR & incidencës së autizmit	Mungesë korrelacioni midis prevalencës së vaksinimit me MMR (e pandryshuar) & rritjes së shpejtë në riskun e autizmit përgjatë viteve
Taylor et al, 1999	UK	Fëmijët me autizëm nën 16 vjeç të lindur përgjatë viteve 1979-1998 (498 fëmijë me ASD)	The Lancet	Krahasim i ndryshimeve në shpeshësinë e ASD në periudhat kur vaksinat MMR nuk kryhej & pasi u fut në programin e vaksinimit në 1987	Nuk ka ndryshim në trendin e autizmit para 1987 & pas 1987-1998

TAB 3. PASQYRA E STUDIMEVE KOHORTE ME FOKUS VAKSINËN MMR & AUTIZMIN

Burimi	Vendi	Kampioni	Revista	Analiza	Rezultati
Mrozek-Budzyn et al, 2013	Poloni	369 fëmijët të lindur në Krakow	Vaccine	Studim prospectiv birth cohort. Zhvillimi i fëmijës u vlerësua me Bayley Scales of Infant Development (BSID-II) deri në moshën 3 vjeç, Raven test në moshat 5 dhe 8 vjeç dhe Wechsler (WISC-R) në moshat 6 dhe 7 vjeç.	Mungon lidhja midis vaksinimit me MMR & zhvillimit kognitiv të fëmijët. Nuk ka dallime në testet kognitive dhe të inteligjencës deri në moshën 2 vjeç mes grupit të vaksinuar dhe të pa vaksinuar me MMR.
Madsen et al, 2002	Danimarkë	Fëmijët e lindur midis viteve 1991-1998 (537.303 fëmijë), burimi i të dhënave Danish Civil Registration system	The New England Journal of Medicine	Studim kohort retrospektiv. U krahasuan 440.665 fëmijë që kishin marrë vaksinën MMR me 96.648 që nuk e kishin marrë vaksinën	Nuk ka dallim në riskun për autizëm mes grupit të vaksinuar & të pa vaksinuar. Nuk ekziston lidhje shkakore MMR-autizëm
Peltola et al, 1998	Finlandë	31 fëmijë për të cilët u raportua se zhvilluan sindroma gastrointestinale pas marrjes së vaksinës MMR	The Lancet	14-year prospective study	Mungon lidhja midis vaksinimit me MMR & shfaqjes së autizmit apo sëmundjes inflamatore të zorrëve

TAB 4. PASQYRA E STUDIMEVE TË TJERA: META-ANALIZË, CROSS-SECTIONAL ME FOKUS VAKSINËN MMR & AUTIZMIN

Burimi	Vendi	Kampioni	Revista	Analiza	Rezultati
Taylor et al, 2014	Mbledhje e disa kampioneve në vende të ndryshme	5 studime case-control & 5 studime kohorte (afro 2 milion fëmijë në total)	Vaccine	Metaanalizë e 10 studimeve.	Mungon lidhja midis vaksinimit me MMR & shfaqjes së autizmit

Honda et al, 2005	Japoni	fëmijët e lindur midis viteve 1988-1996 në Yokohama, qytet në Japoni me popullatë afro 300.000	Journal of Child Psychology and Psychiatry	U studiuan efektet që vijnë pasi hiqet vakcina MMR (përqindja e vaksinimit me MMR u ul ndjeshëm 1988-1992 dhe pas vitit 1993 e 3 vite më pas asnjë nuk u vaksinua me MMR). Matje e incidencës kumulative të ASD deri në moshën 7 vjeç	Heqja e MMR nuk solli ulje të incidencës së autizmit, e cila vazhdoi të rritej përgjatë viteve.
Fombone & Chakrabati, 2001	UK	96 fëmijë të diagnostikuar me ASD të lindur në vitet 1992-1995 pas futjes së vaksinës MMR, 95 prej tyre të vaksinuar me MMR krahasohen me 2 kampionë të tjerë me ASD: 98 fëmijë të pa vaksinuar të lindur midis viteve 1954-1979 para futjes së vaksinës MMR dhe 68 fëmijë të vaksinuar të lindur midis viteve 1987-1996	Pediatrics	Studim cross-sectional. Krahasim i 3 kampionëve për të parë trendin para dhe pas futjes së vaksinës MMR	Mungojnë provat për një variant të autizmit të shkaktuar nga vaksinat. Krahasimi i kampionëve para & pas futjes së vaksinimit me MMR për shpeshhtësinë e shfaqjes së formës së autizmit me regres zhvillimi rezultoi pa domethënie statistikore

TAB. 5. PASQYRA E STUDIMEVE REVIEW ME FOKUS VAKSINËN MMR & AUTIZMIN

Burimi	Vendi	Kampioni	Revista	Analiza	Rezultati
Maglione et al, 2014	USA	67 artikuj	Pediatrics	Review. Fokusi ishte siguria e gjithë vaksinave të rekomanduara për përdorim rutinë në fëmijët 0-6 vjeç në USA, midis të cilave edhe MMR	Mungon lidhja midis vaksinimit me MMR & shfaqjes së autizmit
Wilson et al, 2003	Canada, UK, Skoci	12 artikuj studimorë	Arch Pediatr Adolesc Med.	Review	Mungon lidhja midis vaksinimit me MMR & shfaqjes së autizmit. Për sa i përket lidhjes midis formës së rrallë të ASD dhe MMR ka pak prova epidemiologjike.
Fombone and Cook, 2003			Molecular Psychiatry	Komente mbi studimet e tjera, sidomos Taylor et al, 2002	Nuk ka ndryshim të trendit për autizëm me regresion përgjatë viteve

Në vijim përmblihen të dhënat e disa prej studimeve kryesore në këtë fushë: Kaye dhe bp. (2001) vlerësuan lidhjen e autizmit me vaksinën MMR. Ata bënë analizën e trendit në kohë. Kaye dhe bp. morën në shqyrtim të dhënat e database (GPRD- general practice research database) në UK, në të cilën ishin përfshirë fëmijët deri në moshën 12 vjeç të diagnostikuar me autizëm përgjatë 12 viteve (1988-1999). Ata matën incidencën vjetore të autizmit në moshën kur u diagnostikua për herë të parë për të studiuar lidhjen kohore të vaksinës MMR dhe incidencës së autizmit. Incidenca vjetore e autizmit ishte rritur shtatë herë, nga 0.3 për 10.000 vetë në vitin 1988 në 2.1 për 10.000 individë në vitin 1999. Pavarësisht rritjes së incidencës së autizmit në moshat 2-5 vjeç progresivisht midis viteve 1988-1993, popullata ishte vaksinuar me MMR në mënyrë konstante rreth 97% për çdo kohort vjetor lindjesh. Kjo dëshmoi se nuk ka korrelacion midis prevalencës së vaksinimit me MMR dhe rritjes së shpejtë në riskun e autizmit përgjatë viteve.

Dales dhe bp. në vitin 2001 kryen analizën retrospektive të përqindjeve të vaksinimit të fëmijët e lindur në vitet 1980-1994, të cilët ndiqnin kopshtet në Kaliforni (mostra e survey ishte 600-900 fëmijë çdo vit). Rastet me autizëm të fëmijëve të lindur në ato vite u nxorën nga regjistrimi në sistemin rajonal të shërbimeve për zhvillimin. U shqyrtuan kartelat e vaksinimit të tyre për të përcaktuar moshën në të cilën fëmijët u vaksinuan. Nuk rezultoi korrelacion midis trendit sekular të vaksinimit në Kaliforni dhe trendit sekular të numrit të fëmijëve me autizëm në sistem. Pra të dhënat nuk nxorën lidhje midis vaksinimit me MMR dhe shtimit të rasteve të autizmit.

Në vitin 2002 (Madsen K. et al, 2002) u krye një studim kohor i mbi 500.000 fëmijëve danezë. U krahasuan afro 400.000 fëmijë danezë që kishin marrë vaksinën MMR me afro 100.000 që nuk e kishin marrë vaksinën. U identifikuan 738 fëmijë me ASD, prej të cilëve 608 ishin të vaksinuar me MMR dhe 130 të pa vaksinuar. Studimi tregoi që nuk kishte rritje në incidencën

e autizmit tek fëmijët e ekspozuar me vaksinën MMR krahasuar me fëmijët që nuk e kishin marrë atë vaksinë. Ata gjetën se rreziku i autizmit ishte i njëjtë në të dy grupet.

Uno dhe bp. (2012) kryen studim rastesh me grup kontrolli. Ata përfshinë në studim 189 adultë në moshë të re me çrregullime të spektrit autik dhe 224 subjekte në grupin e kontrollit.

Sipas autorëve marrja e vaksinës MMR nuk lidhet me shtimin e rasteve të reja të autizmit (OR 1.10, 95% CI 0.64–1.90). Një studim me të dhëna unike është ai i kryer nga Honda dhe bp (2005). Studimet e mëparshme nuk testonin dot çfarë ndodh kur faktori i riskut i pretenduar (MMR) të largohej, pra te studioheshin efektet që vijnë pasi largohet shkaktari hipotetik. Honda dhe bp. shqyrtuan incidencën kumulative të ASD deri në moshën 7 vjeç për fëmijët e lindur midis viteve 1988-1996 në Yokohama, qytet në Japoni me popullatë afro 300.000. Incidenca kumulative është numri i rasteve të reja që grumbullohen gjatë një periudhe të caktuar kohore pjesëtuar me numrin e personave në popullatën në risk. Specifika e studimit ishte se përqindja e vaksinimit me MMR në këtë qytet u ul ndjeshëm në vitet 1988-1992 dhe pas vitit 1993 e 3 vite më pas asnjë nuk u vaksinua me MMR. Në të kundërt incidenca kumulative e ASD u rrit ndjeshëm në kohët e lindura në vitet 1988-1996 dhe shumë më tepër duke filluar nga viti 1993. Incidenca kumulative 7 vjeçare e ASD u rrit në mënyrë progresive nga 47.6 për 10.000 fëmijë të lindur në 1988 në 117.2 në të lindurit e vitit 1996, rritja vazhdoi në kohët e fëmijëve që lindën pasi vaksina MMR u hoq dhe nuk ndodhi pakësim në incidencën e ASD në 5 vitet (1988-1992) gjatë të cilave përdorimi i

vaksinës ra nga 69.8% në 0%.

Artikulli i Maglione dhe bp. (2014) pati në fokus sigurinë e gjithë vaksinave të rekomanduara për përdorim rutinë në fëmijët 0-6 vjeç në USA, midis të cilave edhe MMR. Në rezultatet e veta ai konkludoi se të dhënat e studimit tregojnë bindshëm që vaksina MMR nuk lidhet me autizmin (Maglione dhe bp. 2014, fq.325).

Taylor dhe bp. (2014) kryen meta-analizë për të përmbledhur dëshmitë nga studimet case-control dhe ato kohore në Medline, Pubmed, EMBASE, Google Scholar deri në prill 2014. Ata shqyrtuan 5 studime kohore dhe 5 studime case-control (afro 2 milion fëmijë në total të përfshirë në këto studime). Nuk u gjet lidhje midis vaksinimit me MMR dhe autizmit, as komponentëve të vaksinës si timerosali, merkuri.

Konkluzion

Bazuar në të dhënat e literaturës aktuale konkludoj se vaksina MMR nuk shkakton autizëm. Për pasojë moskryerja e vaksinimit që vjen si pasojë e një shkaktari hipotetik i cili u vlerësua si i tillë nga një studiues para shumë vitesh, por nuk ka mbështetjen shkencore aktuale, sjell risqe të tjera të panevojshme në shëndetin publik.

Literatura

- Andrews N, Miller E, Grant A, Stowe J, Osborne V, Taylor B (2004). Thimerosal exposure in infants and developmental disorders: a retrospective cohort study in the United Kingdom does not support a causal association. *Pediatrics*, 114:584-591.
- American Psychiatric Association (2013). *Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders 5th Edition*. Washington, DC.
- Dales L, Hammer SJ, Smith NJ (2001). Time trends in autism and in MMR immunization coverage in California. *J Am Med Assoc*. 2001, 285 (9):1183-1185.
- Davis RL, Kramarz P, Bohlke K, et al. (2001). Measles-mumps-rubella and other measles-containing vaccines do not increase the risk for inflammatory bowel disease: a case control study from the Vaccine Safety Datalink project. *Arch Pediatr Adolesc Med.*,155:354-359.
- DeStefano F, Bhasin TK, Thompson WW, Yeargin-Allsopp M, Boyle C (2004). Age at first measles-mumps-rubella vaccination in children with autism and school-matched control subjects: a population-based study in metropolitan Atlanta. *Pediatrics*, 113:259-266.
- DeStefano F, Chen RT (1999). Negative association between MMR and autism. *Lancet*, 353:1986-1987.
- Farrington CP, Miller E, Taylor B (2001). MMR and autism: further evidence against a causal association. *Vaccine*, 19 (27):3632-3635.
- Finne PE (1993). Herd immunity: history, theory, practice. *Epidemiol Rev.*, 15: 265-302
- Fombonne E, Chakrabarti S (2001). No evidence for a new variant of measles-mumps-rubella-induced autism. *Pediatrics*, 108, DOI: 10.1542/peds.108.4.e58
- Fombonne E, Cook EH Jr (2003). MMR and autistic enterocolitis: consistent epidemiological failure to find an association. *Molecular Psychiatry* 8:133–134. doi:10.1038/sj.mp.4001266
- Heron J, Golding J (2004). Thimerosal exposure in infants and developmental disorders: a prospective cohort study in the United Kingdom does not support a causal association. *Pediatrics*, 114:577-583.
- Honda H, Shimizu Y, Rutter M (2005). No effect of MMR withdrawal on the incidence of autism: a total population study. *J Child Psychol Psychiatry* 46:572-579.
- Hviid A, Stellfeld M, Wohlfahrt J, Melbye M (2003). Association between thimerosal-containing vaccine and autism. *JAMA*, 290:1763-1766.
- Kaye JA, del Mar Melero-Montes M, Jick H (2001). Mumps, measles, and rubella vaccine and the incidence of autism recorded by general practitioners: a time trend analysis. *BMJ*, 322:460-463.
- Madsen KM, Hviid A, Vestergaard M, et al. (2002) A population-based study of measles, mumps, and rubella vaccination and autism. *N Engl J Med.*, 347(19):1477–1482.

- Madsen KM, Lauritsen MB, Pedersen CB, et al (2003). Thimerosal and the occurrence of autism: negative ecological evidence from Danish population-based data. *Pediatrics*, 112:604-606.
- Maglione M A, Das L, Laura Raaen L, Smith A, Chari R, Newberry S, Shanman R, Perry T, Bidwell G M and Courtney G C (2014). Safety of Vaccines Used for Routine Immunization of US Children: A Systematic Review. *Pediatrics*, Volume 134; Nr. 2, 325-338; originally published online July 1, 2014; DOI: 10.1542/peds.2014-1079.
- Mrozek-Budzyn D, Kietyka A, Majewska R (2010). Lack of association between measles-mumps-rubella vaccination and autism in children: a case-control study. *Pediatr Infect Dis J*, 29(5):397-400.
- Mrozek-Budzyn D, Kietyka A, Majewska R, Augustyniak M (2013). Measles, mumps and rubella (MMR) vaccination has no effect on cognitive development in children – The results of the Polish prospective cohort study. *Vaccine*, 31:22, 2551-2557. doi:10.1016/j.vaccine.2013.03.057
- Mrozek-Budzyn D, Majewska R, Kietyka A, Augustyniak M (2012). Neonatal exposure to Thimerosal from vaccines and child development in the first 3 years of life. *Neurotoxicology and Teratology*, 34:6, 592-597. doi:10.1016/j.ntt.2012.10.001
- Peltola H, Patja A, Leinikki P, Valle M, Davidkin I, Paunio M (1998). No evidence for measles, mumps and rubella vaccine associated inflammatory bowel disease or autism in a 14-year prospective study. *The Lancet*, 351:1327-1328.
- Picciotto IH, Green PG, Delwiche L, et. al (2010). Blood mercury concentrations in charge study children with and without autism. *Environ Health Perspect*. 2010;118(1):161-166.
- Price CS, Thompson WW, Goodson B, et. al (2010). Prenatal and infant exposure to thimerosal from vaccines and immunoglobulins and risk of autism. *Pediatrics*, 126:656-664.
- Schechter R, Grether J (2008). Continuing increases in autism reported to California's developmental services system: mercury in retrograde. *Arch Gen Psychiatry*, 65:19-24.
- Smeeth L, Cook C, Fombonne E, et al. (2004). MMR vaccination and pervasive developmental disorders: a case-control study. *The Lancet*, 364(9438):963-969.
- Stehr-Green P, Tull P, Stellfeld M, Mortenson PB, Simpson D (2003). Autism and thimerosal-containing vaccines: lack of consistent evidence for an association. *Am J Prev Med.*, 25:101-106.
- Taylor B, Miller E, Farrington CP, Petropoulos MC, Favot-Mayaud I, Li J, Waight PA (1999). Autism and measles, mumps, and rubella vaccine: no epidemiological evidence for a causal association. *The Lancet*, 353(9169):2026-2029.
- Taylor LE, Swerdfeger AL, Eslick GD (2014). Vaccines are not associated with autism: an evidence-based meta-analysis of case-control and cohort studies. *Vaccine*, 32(29):3623-9, doi: 10.1016/j.vaccine.2014.04.085. Epub 2014 May 9.
- Tozzi AE, Bisiacchi P, Tarantino V, et. al. (2009). Neuropsychological performance 10 years after immunization in infancy with thimerosal-containing vaccines. *Pediatrics*, 123(2):475-482.
- Uno Y, Uchiyama T, Kurosawa M, Aleksic B, Ozaki N (2015). Early exposure to the combined measles-mumps-rubella vaccine and thimerosal-containing vaccines and risk of autism spectrum disorder. *Vaccine*, 33:2511-2516. Elsevier.
- Uno Y, Uchiyama T, Kurosawa M, Aleksic B, Ozaki N (2012). The combined measles, mumps, and rubella vaccines and the total number of vaccines are not associated with development of autism spectrum disorder: the first case-control study in Asia. *Vaccine*, 30(28):4292-4298.
- Vaccine Education Center - The Children's Hospital of Philadelphia (2012). Vaccines and Autism: What you should know Vol 2., f. 1-4. vaccine.chop.edu
- Verstraeten T, Davis RL, DeStefano F, et al (2003). Study of thimerosal containing vaccines: a two-phased study of computerized health maintenance organization databases. *Pediatrics*, 112:1039-1048.
- Wakefield A J, Murch S H, Anthony A, Linnell J, Casson D M, Malik M, Berelowitz M, Dhillon A P, Thomson M A, Harvey P, Valentine A, Davies S E, Walker-Smith J A (1998). Ileallymphoid-nodular hyperplasia, non-specific colitis, and pervasive developmental disorder in children. *The Lancet*, 351, 637-641.
- Wilson K, Mills E, Ross C, McGowan J, Jadad A (2003). Association of autistic spectrum disorder and the measles, mumps and rubella vaccine: a systematic review of current epidemiological evidence. *Arch Pediatr Adolesc Med*. 157:628-634.

RAPORTIMET E PRINDËRVE MBI VONESAT GJUHËSORE TË FËMIJËVE ME AUTIZËM NË 5 VITET E PARA TË JETËS

VOLTISA LAMA, PHD

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Psikologji.

Corresponding author E-mail: voltisa.lama@uet.edu.al

Voltisa Lama, PhD Formim klinik dhe licencim si specialiste në fushën e shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve. Fokusi si lektore dhe interesat kërkimorë janë në Psikologjinë e zhvillimit dhe Psikopatologjinë e fëmijërisë dhe adoleshencës. Pozicioni aktual: Pedagoge në Universitetin Europian të Tiranës, Departamenti i Edukimit – dega Psikologji; Psikiatre për fëmijë & adoleshentë (konsulente në shërbim privat)

ANISA FERIZI

Psikologe

ABSTRAKT

Qëllimi i studimit: Prindërit janë vëzhguesit e parë të zhvillimit të fëmijës. Janë ata të parët që mund të dallojnë se diçka nuk po ecën tek fëmija i tyre sipas rrjedhës së zakonshme të zhvillimit. Duke pasur këtë gjë parasysh si edhe rëndësinë e identifikimit të hershëm, fokusi i këtij studimi janë raportimet e prindërve mbi vonesat gjuhësore të fëmijëve me autizëm në 5 vitet e para të jetës.

Metoda: Kampioni i studimit përbëhet nga 30 fëmijë me autizëm në moshat 2-4.5 vjeç, të cilët vijnë nga 15 rrethe të ndryshme të Shqipërisë. Prindërit iu përgjigjën një pyetësori të krijuar nga autoret e studimit, i cili kërkonte të identifikonte shenjat e hershme të autizmit, midis të cilave edhe të folurin, si edhe moshën e shfaqjes së tyre.

Rezultatet: 83% e fëmijëve në këtë kampion shfaqin vonesa të gjuhës së folur sipas raportimit të prindërve. Në këtë grup pjesa më e madhe e prindërve (62%) janë shqetësuar për të folurin e fëmijës në moshat 2-2.5 vjeç. Vetëm 11% janë shqetësuar para moshës 2 vjeç. Një përqindje e konsiderueshme (27% e prindërve) janë shqetësuar për të folurin pas moshës 3 vjeçare, çfarë çon në vonesë diagnostikimi dhe marrje terapie specifike edukative për fëmijët me autizëm.

Fjalë kyç: *autizëm, vonesa gjuhësore, raportimi i prindërve, mosha e njohjes*

Hyrje

Prindërit janë vëzhguesit e parë të zhvillimit të fëmijës. Janë ata të parët që mund të dallojnë se diçka nuk po ecën tek fëmija i tyre sipas rrjedhës së zakonshme të zhvillimit. Megjithëse ndërgjegjësimi për diagnozën e hershme ka rritur ndjeshmërinë e popullatës, vonesat në zbulimin e rasteve me autizëm janë relativisht të zakonshme. Në USA identifikimi i hershëm i autizmit është bërë prioritet kombëtar, por megjithë përpjekjet ka fëmijë të cilët identifikohen në një moshë të vonë (Valicenti-McDermott M et al., 2012). Disa studime (Lord et al., 2001; Bryson et al., 2003; Weatherby & Woods, 2004; Landa & Garret-Mayer, 2006; Dawson et al., 2010) mbështesin rolin e shërbimeve intensive specifike për autizmin në 3 vitet e para të jetës për të pasur përfitime në ecurinë e zhvillimit të fëmijës. Fokusi i këtij shkrimi janë raportimet e disa prindërve shqiptarë mbi vonesat gjuhësore të fëmijëve me autizëm në 5 vitet e para të jetës. Në dijeninë tonë nuk ka pasur studime të mëparshme me këtë fokus në Shqipëri. Hulumtohet gjithashtu koha kur problemet në komunikimin gjuhësor bëhen të kuptueshme për prindërit.

Çrregullimi i spektrit të autizmit (ASD) karakterizohet nga modele të vonesave dhe deviancave në aftësitë sociale, komunikuese dhe kognitive. Autizmi është çrregullim i neurozhvillimit, çka do të thotë se anomalitë në zhvillimin nervor krijohen që kur foshnja është në barkun e nënës. Faktorët patogjentikë të cilët lidhen me mosfunksionimin social mund të jenë të pranishëm qysh në lindje, megjithëse rëndesa e simptomave dhe modeli kohor i shprehjes së tyre mund të variojë në varësi të gjenetikës dhe zhvillimit të trurit si edhe faktorëve ambientale. Dallime të tilla mund të çojnë në nxitjen e shqetësimit prindëror në kohë të ndryshme dhe ndoshta për arsye të ndryshme (Chawarska et al., 2007). Shfaqja e simptomave ndodh patjetër në vitet e para të jetës, kriteri diagnostik kërkon shfaqjen para moshës 3 vjeçare (APA, 2013). Megjithëse ka shenja jo specifike të hershme përgjatë vitit të parë të jetës të cilat kuptohen zakonisht nga profesionistët, simptomat e ASD fillojnë të manifestohen në mënyrë tipike në dy vitet e para të jetës. Ka pak dëshmi për sa i përket tipit dhe kohës së shfaqjes së simptomave (Chawarska et al., 2007).

Kriter bazë diagnostik i çrregullimit të spektrit autik (kriteri A, pika 2 në DSM-V) është deficitin në komunikimin social, ai gjithashtu vendoset edhe si një ndër specifikuesit shoqëruar të diagnozës, duke qenë se lidhet me prognozën. Vonesa në zhvillimin gjuhësor është ndër shenjat më të hershme të raportuara. Karakteristika që bie më shumë në sy të prindërve, e cila renditet edhe si një nga shqetësimet më të hershme prindërore për këtë grup fëmijësh janë problemet me komunikimin verbal (De Giacomo & Fombonne, 1998; Chawarska et al., 2007, Volkmar et al., 2008), në ndryshim nga sjelljet stereotipike dhe përsëritëse të cilat pavarësisht faktit se janë kriter diagnostik (kriteri B, pika 1 në DSM-V) nuk bien në vëmendjen prindërore si shqetësuese për zhvillimin (Rogers, 2000; Volkmar et al., 2008). Ankesë shumë e zakonshme e prindërve është fakti se fëmija nuk dëgjon dhe shpesh fillimisht paraqiten tek mjeku otorinolaringolog për probleme të dëgjimit. Në sensitivitetin e prindërve për të dalluar problematikat gjuhësore te fëmija ndikojnë gjithashtu edhe pritshmëritë që ata kanë për zhvillimin gjuhësor të fëmijës, të cilat lidhen me njohuritë e prindërve mbi trajektoren e zhvillimit të folurit, arsimimin, mungesën e përvojës me fëmijën e parë, kulturën. Gjithashtu prindërit mund të shqetësohen për zhvillimin e fëmijës në moshë të vogël, por ata ndodh që sigurohen prej familjarëve më të moshuar të cilët flasin për raste të ngjashme në familje të cilët i kanë kapërcyer problemet me kalimin e viteve. Rol të rëndësishëm luajnë edhe mekanizmat psikologjikë të represionit dhe mohimit për arsye të ankthit dhe dhimbjes që shkakton përballja me këtë problematikë.

Për hulumtimin e indikatorëve të hershëm të autizmit janë kryer si studime retrospektive dhe prospektive, secili prej të cilëve ka avantazhe dhe kufizime specifike (Zwaigenbaum et al., 2009). Hulumtuesit e interesuar për të pasqyruar simptomat e autizmit në moshën e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël zakonisht kanë përdorur metoda retrospektive, në ndryshim nga kërkimet e kryera të parashkollorët dhe fëmijët më të rritur (Goin-Kochel & Meyers, 2005). Metoda e ndjekur në disa studime ka qenë shqyrtimi i videove të fëmijëve tashmë të diagnostikuar me çrregullime të spektrit autik (Adrien et al., 1993, Carmagnat-Dubois et al., 1997; Baranek 1999; Werner et al., 2000; Zakian et al., 2000, Werner & Dawson, 2005). Studime të tjera kanë pasqyruar raportimet e prindërve të fëmijëve me autizëm për sa i përket karakteristikave që fëmijët shfaqin në foshnjëri dhe fëmijërinë e hershme (De Giacomo & Fombonne, 1998; Smith et al., 1994; Vostanis, et al., 1998; Werner & Munson 2001; Young et al., 2003). Meqënëse kjo metodologji është kritikuar për faktin që memorja e prindërve mund të mos pasqyrojë të dhëna të sakta, vlefshmëria e raportimit mund të përmirësohet duke u fokusuar tek raportimet e prindërve me fëmijë të vegjël, çka nuk kërkon kujtime të shumë viteve më parë (Goin-Kochel & Myers, 2005). Në literaturë ka edhe studime të cilat kërkojnë të njihen me shenjat e hershme të autizmit përmes studimeve “te foshnjat në risk”- si të tilla konsiderohen vëllezërit/motrat e fëmijëve të diagnostikuar me autizëm (Barbaro & Dissanyake, 2009, f. 1100). Dhënia peshë gjithnjë në rritje e faktorëve genetikë në autizëm dhe risku i shtuar për çrregullim të spektrit të autizmit (ASD) te vëllezërit/motrat e fëmijëve të prekur me autizëm mund të ndërgjegjësojë prindërit për shenjat e hershme dhe të kontribuojë në njohjen më të hershme të problemeve të zhvillimit (Chawarska et al., 2007). Përputhshmëria midis rezultateve të marra nga instrumentet e ndryshme të përdorura për zbulimin e shenjave të hershme të autizmit ka pasqyrim jounifom në literaturë, në varësi edhe se cili është fokusi i studimit. Kështu duket se për sa i përket shfaqjes për herë të parë të simptomave të çrregullimit të spektrit autik ka pak përputhshmëri midis metodikës që bazohet te videot e regjistruara në shtëpi krahasuar me raportimin prindëror (Ozonoff S et al., 2011). Vetë prindërit nuk mund të jenë në nivel profesionisti për të dalluar shfaqjet e hershme të fëmija. Për tema të tjera më të zakonshme si komunikimi gjuhësor prindërit shfaqen më të besueshëm në raportimet e tyre. Kështu në një studim në Oslo u hulumtua përputhshmëria në vlefshmërinë e rezultateve të marra nga raportimi prindëror (CDI-Communicative Development Inventory) krahasuar me testet direkte gjuhësore (RDSL-Reynell Developmental Language Scales) për sa i përket vlerësimit gjuhësor të 55 fëmijëve me autizëm dhe rezultoi përputhshmëri e mirë në rezultatet e të dy metodave (Nordahl-Hansen et al., 2014).

Metoda

Pyetjet kërkimore dhe hipoteza: Sa të shpeshta janë vonesat gjuhësore në kampionin e studiuar? Në cilën moshë të fëmijës i vënë re prindërit problemet gjuhësore për herë të parë? Si raportohet ecuria e të folurit të kampionit? Duke u bazuar në faktorët ndikues prindëror të përshkruar më sipër, si edhe përvojën si kliniciste pasi shumica e prindërve me autizëm e sjellin fëmijën për vlerësim në klinikë pas moshës 2 vjeç e gjysmë, hipoteza e këtij studimi është që në një pjesë rastesh pritet vonesë në dallimin e ecurisë së të folurit.

Kampioni i studimit përbëhet nga 30 fëmijë në moshat 2-4.5 vjeç, të diagnostikuar me çrregullim të spektrit autik, të cilët vijnë nga rrethe të ndryshme të Shqipërisë. Diagnoza e çrregullimit të spektrit autik është e konfirmuar, pasi të gjithë fëmijët kanë frekuentuar Qendrën Kombëtare për Mirërritjen, Zhvillimin & Rehabilitimin e Fëmijëve në Tiranë. Në studim u përfshinë vetëm prindërit e fëmijëve me autizëm të cilët shin 5 vjeç ose më të vegjël në momentin e plotësimit të pyetësorit, për të përmirësuar vlefshmërinë e raportimit retrospektiv. Përzgjedhja e fëmijëve u bë si raste të njëpasnjëshme të cilat paraqiteshin në Qendrën Kombëtare për Mirërritjen, Zhvillimin & Rehabilitimin e Fëmijëve në Tiranë gjatë periudhës tetor 2014-janar 2015 dhe plotësonin kriterin e moshës.


Instrumenti: Për të marrë raportimin e prindërve u krijua një pyetësor nga autorët e studimit, i cili kërkonte të identifikonte me anë të raportimit shenjat e hershme të autizmit midis të cilave edhe të folurin, si edhe moshën e shfaqjes së tyre. Pyetësori u testua fillimisht tek tre prindër të fëmijëve të diagnostikuar me çrregullime të spektrit autik dhe u bënë disa riformulime të fjalive për të qenë sa më të kuptueshme. Pyetësori u plotësua nga prindërit në prani të psikologes së Qendrës dhe njëres prej autoreve të studimit, e cila ndiqte vitin e fundit të studimeve për Psikologji. Meqenëse pyetësori identifikoi një larmi shenjash të hershme të fëmijët me autizëm (p.sh. bashkëveprimi social, interesat specifike, etj.) në kuadër të një punimi diplome, vetëm problemet gjuhësore do të jenë fokus i këtij shkrimi. Disa nga pyetjet e pyetësorit (përkatësisht 2, 3 dhe 4) ishin fokusuar në zhvillimin gjuhësor të fëmijës. Pyetja e parë kërkonte të hulumtonte pjesën e kampionit me probleme gjuhësore dhe moshën kur nga prindërit ishin vënë re vonesa gjuhësore tek fëmija i tyre. Ajo përmbante formulime të mbyllura (vonesë gjuhësore po/ jo, moshë) dhe formulime të hapura për të përthithur informacion shtesë nga prindërit. Dy pyetjet vijuese u formuluan për të bërë kontroll të dyfishtë të pyetjes së parë, me qëllim që të përforcohej saktësia e të dhënave si edhe marrjen e informacionit shtesë. Pyetja 3 kërkonte të hulumtonte moshën kur prindërit shqetësoheshin për zhvillimin gjuhësor të fëmijës së tyre, si edhe për të parë boshllëkun kohor midis moshës kur prindërit vënë re vonesën gjuhësore dhe momentit kur ata shqetësohen për këtë vonesë. Pyetja e fundit në këtë sferë hulumtoi ecurinë e zhvillimit gjuhësor. Prindërve iu kërkua të raportonin mbi momente kyçe të zhvillimit gjuhësor të fëmijës së tyre duke specifikuar edhe moshat kur fëmija realizonte rrokje (p.sh. ma, ba), fjalor deri në 10 fjalë, fjalor prej 10-50 fjalësh, ndërtimin e një fjalie të thjeshtë me 3 fjalë dhe më tej lidhjen e mendimit në 3-4 fjali të bashkuara. Analizimi i zhvillimit gjuhësor rast pas rasti bazuar në të dhënat e raportuara u krye nga njëra prej autoreve të studimit, me profesion psikiatër për fëmijë & adoleshentë.

Analiza e të dhënave: U krye me Exel. U përdor statistika deskriptive.

Rezultatet

Në vijim (tab. 1, tab. 2) përshkruhen të dhënat demografike të fëmijëve dhe të prindërve të tyre, të cilët plotësuan pyetësorin. Në kohën kur u krye studimi moshë mesatare e fëmijëve të kampionit ishte 3.2 vjeç (spektri 2-4.5 vjeç), mbizotëronin meshkujt mbi 3 herë më shumë se femrat. Fëmijët frekuentonin Qendrën Kombëtare për Mirërritjen, Zhvillimin & Rehabilitimin e Fëmijëve në Tiranë. Të dhënat u raportuan në shumicën e rasteve nga nënat (76% vs. 24% baballarë). Një baba kishte 2 fëmijë me autizëm dhe plotësoi pyetësorin për secilin.

TAB. 1: TË DHËNAT DEMOGRAFIKE TË FËMIJËVE



TAB. 2: TË DHËNAT DEMOGRAFIKE TË PRINDËRVE

Variabili	Spektri ose % (n)	
Mosha	23-40 vjeç (mesatarja 29.5, SD 4.5)	
Gjinia	Nëna	76%
	Baballarë	24%
Arsimimi	tetëvjeçar	21%
	i mesëm	69%
	i lartë	10%

83% e kampionit ka paraqitur vonesa gjuhësore (tab. 3) sipas raportimit të prindërve. Prindërit i kanë vënë re këto vonesa në mosha të ndryshme. Rezultatet e pyetjes së hapur mbi problematikat gjuhësore përshkruhen në tabelën vijuese (tab. 4), por të dhënat janë të pakta pasi vetëm 1/3 e grupit dha shpjegime. Kryesisht prindërit janë shqetësuar për fjalorin joadekuat për moshën e zhvillimit, si edhe një pjesë fëmijësh realizonte komunikimin me gjeste pa e shoqëruar atë me fjalë.

TAB. 3: RAPORTIMI I PROBLEMEVE GJUHËSORE TË FËMIJËVE ME AUTIZËM

Përparimi gjuhësor	%	n	%	Mosha respektive kur është vënë re nga prindi vonesa	
Raportohen vonesa të gjuhës së folur	83%	25	16	64%	1-2 vjeç
			7	28%	2-3 vjeç
			2	8%	3-4 vjeç
Nuk raportohen vonesa të gjuhës së folur	17%	5	-		


TAB. 4: LLOJET E PROBLEMATIKAVE GJUHËSORE TË PËRSHKRUARA NGA PRINDËRIT

Llojet e problematikave gjuhësore të përshkruara nga prindërit	%	n	Moshat kur shfaqen
Nuk ka fjalorin e përshtatshëm për moshën	24%	6	1.5-2.5 vjeç
Ekziston komunikimi joverbal ndaj nevojave, por nuk shoqërohet me komunikimin verbal	8%	2	2 vjeç - 2.5 vjeç
Kanë problematika gjuhësore, por nuk specifikohet	68%	17	1.5-3.5 vjeç


Grafiku 1 paraqet trendin e shqetësimit prindëror përgjatë 5 viteve të para të jetës së fëmijës. Prindërit e këtij kampioni janë shqetësuar për të folurin e fëmijës në moshat nga 1 deri 3.5 vjeç (mesatarja e grupit 2.4 vjeç). Grafiku 2 i grupon të dhënat sipas grupmoshave, për ti bërë rezultatet më të komunikueshme në shifra prevalence. Vihet re se në grupin me vonesa të të folurit pjesa më e madhe e prindërve (62%) janë shqetësuar për të folurin e fëmijës së tyre në moshat 2-2.5 vjeç. Vetëm 11% janë shqetësuar para moshës 2 vjeç. Një përqindje e konsiderueshme (27% e prindërve të kampionit) janë shqetësuar për të folurin pas moshës 3 vjeçare, çka sjell vonesë diagnostikimi të fëmijëve.

Nëse krahasojmë moshat kur prindi shqetësohet (graf. 2) me moshat që prindi ka vënë re vonesat gjuhësore (tab. 3) ka një hapësirë kohore midis tyre, pra prindërit i kanë vënë re vonesat më herët, por mesa duket kanë kaluar një periudhë pritje deri në momentin që e kanë konsideruar shqetësues zhvillimin gjuhësor të fëmijës.

GRAF. 1: MOSHA KUR PRINDI SHQETËSOHET PËR TË FOLURËN E FËMIJËS




GRAF. 2: SHQETËSIMI PËR TË FOLURËN E FËMIJËS SIPAS GRUPMOSHAVE



Bazuar në të dhënat e pyetjes së fundit u analizua zhvillimi gjuhësor i secilit fëmijë. Analiza u krye për 87% të rasteve, pasi në 13% të pyetësorëve nuk kishim të dhëna të mjaftueshme. Ecuria e zhvillimit gjuhësor nuk ishte homogjene në këtë grup. Ajo mund të ndahet në tre modele: 70% e fëmijëve në këtë kampion kanë shfaqur vonesa që të rrokjet (tab. 5) dhe kanë ngecur ose kanë ecur shumë pak në zhvillimin gjuhësor p.sh. kanë thënë disa fjalë deri nga mosha 3 vjeç. Nëse fëmija flet më pak se 50 fjalë deri në 2 vjeç ai konsiderohet “me dëmtime shoqëruese gjuhësore”. Për 10% të fëmijëve zhvillimi gjuhësor nuk ka rënë në vëmendje të prindërve si problematik. Këta fëmijë kanë përparuar më ngadalë, ata arritën të lidhin fjalitë në mosha më të vonuara sesa norma e zhvillimit. 7% e fëmijëve nuk kanë shfaqur vonesa sipas raportimit të prindërve.

GRAF. 3: ECURIA E ZHVILLIMIT GJUHËSOR



TAB. 5: PËRSHKRIMI I ZHVILLIMIT GJUHËSOR TE FËMIJËT ME AUTIZËM

Ecuria e zhvillimit gjuhësor	%	n	Përshkrimi
Vonesë	70%	21	<ul style="list-style-type: none"> Vonesë të shfaqura që tek rrokjet 12 fëmijë, i realizojnë në moshat 1.5 vjeç (n=5), 2 vjeç (n=5), 2.5 vjeç (n=2). Këta 12 fëmijë nuk kanë përparuar më tej 5 fëmijë i thonë rrokjet përafërsisht në kohë dhe më pas ngecin në zhvillimin gjuhësor Vonesë të shfaqura që tek rrokjet 4 fëmijë, i realizojnë në moshat 2-2.5 vjeç dhe përparojnë shumë pak në fjalor deri 10 fjalë përgjatë një harku kohor prej gjysëm viti
Përparim i ngadaltë i zhvillimit gjuhësor	10%	3	Kanë ngadalësim kryesisht pas moshës 2 vjeç, megjithatë arrijnë të realizojnë lidhjen e fjalive ndonëse me vonesë, në moshën 3-4 vjeç
Nuk ka vonesë	7%	2	
Mungojnë të dhënat	13%	4	

Diskutime

Të dhënat demografike të kampionit tonë replikojnë **të dhënat e literaturës për** sa i përket raportit gjinor dhe janë përfaqësuese të shtresave të popullatës shqiptare me arsimim të ndryshëm dhe vendbanim të ndryshëm. Fëmijët vinin nga 15 rrethe të ndryshme të Shqipërisë, kampioni kishte shtrirje gjeografike në gjithë zonat e Shqipërisë. Për sa i përket arsimimit kampioni kishte përfaqësime të tre niveleve, pjesa më e madhe e prindërve (afro 70%) kishin arsim të mesëm. Shtresëzimi i mirë ndikon pozitivisht në përfaqësimin e rezultateve të studimit, pasi faktorët demografikë lidhen me sensitivitetin e prindërve për të kuptuar shenjat e hershme të autizmit. Valicenti-McDermott et al. (2012) në Qendrën e Vlerësimit dhe Rehabilitimit në Bronx, New York studiuar faktorët demografikë të fëmijës/familjeve të 473 fëmijëve të diagnostikuar me autizëm në këtë qendër universitare dhe lidhjen e këtyre faktorëve me moshën e diagnostikimit të fëmijës. Ata konkluduan se ka dallime, konkretisht foshnjat e lindura në vende të tjera dhe foshnjat e nënave të huaja kishin më shumë të ngjarë t'i sillnin fëmijët më vonë për vlerësim në Qendër. Raporti gjinor i kampionit tonë (77% meshkuj vs. 23% femra, raporti M:F 3 deri 4:1) përputhet me të dhënat e studimeve të tjera (78% meshkuj vs. 22% femra në kampionin prej 55 fëmijësh të Nordahl-Hansen et al., 2014; 76% meshkuj vs. 24% femra në kampionin prej 473 fëmijësh 1-6 vjeç të Valicenti-McDermott et al., 2012).

Prindërit raportuan se 83% e fëmijëve në këtë kampion shfaqnin vonesa të gjuhës së folur. Nuk u raportuan vonesa gjuhësore në 17% të kampionit, por sipas analizës më specifike që u bë në pyetjen 4 e cila hulumtoi ecurinë gjuhësore retrospektive (shih tab. 5) prej shifrës 17% vetëm 7% e kampionit nuk rezultoi me vonesa gjuhësore, kurse 10 % patën përparim të ngadaltë të zhvillimit gjuhësor i cili u konsiderua prej prindërve si normë në kohën kur u pyetën. Vihet re se në grupin me vonesa të të folurit pjesa më e madhe e prindërve (62%) janë shqetësuar për të folurin e fëmijës së tyre në moshat 2-2.5 vjeç.

Rezultatet janë të përafërta me studimin e Young et al. (2003, f. 23), në të cilin 77.8% e prindërve (n=81) kishin raportuar vonesa gjuhësore në moshën mesatare 18.4 muaj për këtë kampion. Në studimin e Kishore & Basu (2011) nënat e përfshira në kampionin e studuar (n=50) u shqetësuan për zhvillimin e fëmijës së tyre me autizëm (jo specifikisht zhvillimit gjuhësor, pyetja kërkimore e tyre ishte përgjithëse) mesatarisht në moshën 2.3 vjeç. **Në kampionin tonë shqetësimi i grupit të prindërve për zhvillimin gjuhësor ishte në moshën mesatare 2.4 vjeç.** Rezultatet janë në shifra të përafërta gjithashtu me studimin e Nordahl et al., 2014 i cili me anë të testeve direkte gjuhësore vlerësoi 2 shkallët gjuhësore receptive dhe ekspresive (n=55) në të cilat 49.1% e fëmijëve rezultuan me pikë të ulëta në gjuhën ekspresive dhe 43.6 % e tyre në shkallën receptive. Shqetësimi prindëror është më i shprehur në kampionin tonë krahasuar me studimin e Chawarska et al. 2007 ku 70.6% e prindërve (n=75) shqetësoheshin për vonesat gjuhësore, megjithatë krahasuar me shenjat e tjera si vështirësitë sociale, sjelljet stereotipike, problemet mjekësore vonesat gjuhësore ishin shqetësimi më mbizotërues i prindërve amerikanë.

Në kampionin tonë nuk u raportua asnjë fëmijë me regres në zhvillimin gjuhësor (aftësitë gjuhësore përparojnë normalisht deri në një moshë të caktuar dhe humbasin papritur). Megjithëse trajektorja e zhvillimit me regres raportohet në literaturë rastet mund të jenë të pakta ose jo domosdoshmërisht diagnoza përkon me autizmin. Aq më tepër regressi i raportuar nga prindërit duhet marrë me rezervë, pasi nuk tregon domosdoshmërisht zhvillim normal në periudhën para humbjes së perceptuar të aftësisë të fëmijës (Lord et al, 2004; Werner & Dawson, 2005).

Një përqindje e konsiderueshme e prindërve të kampionit (27%) janë shqetësuar për të folurin pas moshës 3 vjeçare, çka çon në vonesë diagnostikimi dhe marrje terapie specifike edukative për fëmijët me autizëm. Kjo gjetje e studimit mund të lidhet me arsyet e lartpërmendura si njohuritë e prindërve mbi trajektoren e zhvillimit të të folurit, ecja me shpresë se e folura do të rikuperohet me rritjen e fëmijës, sigurimi prej familjarëve më të moshuar për raste të ngjashme në familje të cilët

i kanë kapërcyer problemet me kalimin e viteve, mekanizmat psikologjikë të represionit dhe mohimit për arsye të ankthit që shkakton përballja me këtë problematikë. Përveç mediatizimit të autizmit, në diagnostikimin e hershëm ndihmon edhe nxitja e prindërve të rinj për të pasur disa njohuri bazike mbi zhvillimin normal të fëmijës si edhe ndërgjegjësimi për të qenë më të hapur ndaj këshillimit me profesionistin edhe kur ka problematika të vogla që prindi i vë re te fëmija pa arritur nivelin shqetësues.

Kufizimet e studimit

Një kufizim i studimit është numri i vogël i kampionit, megjithatë duke pasur parasysh se kampioni paraqet një grup klinik, i cili nuk është lehtësisht i aksesueshëm dhe studimi pati si kritere inkluduese fëmijët me autizëm më të vegjël se 5 vjeç, paraqitja e rezultateve ka vlerë skrinuese dhe parapërgatitëse për studime më të zgjeruara.

Megjithëse prindërit mund të japin një vlerësim të vlefshëm të aftësive gjuhësore të fëmijëve të tyre (Nordahl-Hansen et al., 2014) dhe pavarësisht përpjekjeve tona për të minimizuar problemet e metodologjisë retrospektive duke përfshirë fëmijë në moshë të vogël, vetë-raportimi mbetet kufizim i vlefshëm të dhënave të studimit. Studime të mëtejshme me numër më të madh kampioni, vlerësim prospektiv dhe përdorim burimesh të shumfishta vlerësuese mund të japin konkluzione përgjithësuese.

Vonesat në kohën kur prindi kupton se fëmija paraqet rrjedhë atipike të zhvillimit të gjuhës së folur mund të jenë akoma më të mëdha se ato që paraqitën rezultatet. Përfshirja në studim vetëm e fëmijëve të vegjël që frekuentonin Qendrën dhe ish-in të diagnostikuar nga njëra anë është pozitive për saktësinë metodike, por nga ana tjetër na shtyn të mendojmë se ky grup prindërisht mund të kenë qenë më të vëmendshëm krahasuar me prindër të tjerë të cilët mund t'i kenë sjellë fëmijët për vlerësim diagnostikues pas moshës 5 vjeçare.

Një kufizim tjetër që lidhet me diskutimin e rezultateve është se studimi nuk matë koeficientin e inteligjencës së fëmijëve dhe as rëndesën e simptomave. Prania e prapambetjes mendore në shoqërim me prapambetjen mendore, vonesat në momentet kyçe të zhvillimit dhe problemet mjekësore tenton të nxisë shfaqjen e shqetësimit prindëror më herët krahasuar me rastet ku çrregullimi i spektrit të autizmit nuk shoqërohet me këto problematika (Chawarska et al., 2007).

Bibliografia

- Adrien, J. L., Lenoir, P., Martineau, J., Perrot, A., Hameury, L., Larmande, C., & Sauvage, D. (1993). Blind ratings of early symptoms of autism based upon family home movies. *Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry*, 32(3), 617-627.
- American Psychiatric Association (2013). *Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders (5th Edition)*. Washington: American Psychiatric Publishing.
- Baranek, G.T. (1999). Autism during infancy: A retrospective video analysis of sensory-motor and social behaviors at 9-12 months of age. *Journal of Autism and Developmental Disorders*, 29, 213-224.
- Barbaro, J., & Dissanayake, C. (2009). Autism spectrum disorders in infancy and toddlerhood: A review of the evidence on early signs, early identification tools, and early diagnosis. *Journal of Developmental & Behavioral Pediatrics*, 30, 447-459.
- Bryson, S., Rogers, S. J., & Fombonne, E. (2003). Autism spectrum disorders: Early detection, intervention, education, and psychopharmacological management. *Canadian Journal of Psychiatry*, 48, 506-516.
- Carmagnat-Dubois, F., Desombre, H., Perrot, A., Roux, S., Le Noir, P., Sauvage, D., & Garreau, B. (1997). Autism and Rett syndrome: A comparison study during infancy using family home movies. *L'Encephale*, 23, 273-279.
- Chawarska K, Paul R, Klin A, Hannigen S, Dichtel LE, Volkmar F (2007). Parental Recognition of Developmental Problems in Toddlers with Autism Spectrum Disorders. *Journal of Autism and Developmental Disorders*, 37(1):62-72, DOI 10.1007/s10803-006-0330-8. Springer
- Chung, M.C., Smith, B., & Vostanis, P. (1995). Detection of children with autism. *Educational and Child Psychology*, 12, 31-36.
- Dawson G, Rogers S, Munson J, Smith M, Winter J, Greenson J, et al. (2010). Randomized, controlled trial of an intervention for toddlers with autism: The early start Denver model. *Pediatrics* 2010;125:e17-23.
- De Giacomo, A. & Fombonne, E. (1998). Parental recognition of developmental abnormalities in autism. *European Child and Adolescent Psychiatry*, 7, 131-136.
- Goin-Kochel R P & Meyers B J (2005). Parental report of early autistic symptoms: Differences in ages of detection and frequencies of characteristics among three autism-spectrum disorders. *Journal of Autism and Developmental Disorders*, 11(2):21-39
- Kishore MT, Basu A (2011). Early concerns of mothers of children later diagnosed with autism: Implications for early identification. *Research in Autism Spectrum Disorders* 5: 157-163. Elsevier.
- Landa, R., & Garrett-Mayer, E. (2006). Development in infants with autism spectrum disorders: A prospective study. *Journal of Child Psychology and Psychiatry*, 47, 629-638.
- Lord C, McGee JP, eds. (2001). *Educating children with autism*. Washington, D.C.: National Academy Press
- Lord, C., Shulman, C., & DiLavore, P. (2004). Regression and word loss in autistic spectrum disorders. *Journal of Child Psychology & Psychiatry*, 45(5), 936-955.
- Nordahl-Hansen A, Kaale A, Ulvund SE (2014). Language assessment in children with autism spectrum disorder: Concurrent validity between report-based assessments and direct tests. *Research in autism spectrum disorders* 8:1100-1106
- Ozonoff S, Iosif AM, Young GS, Hepburn S, Thompson M, Colombi C, Cook IC, Werner E, Goldring S, Baguio F, Rogers SJ (2011). Onset patterns in autism: correspondence between home video and parent report. *J Am Acad Child Adolesc Psychiatry*

- 50(8):796-806.e1. doi: 10.1016/j.jaac.2011.03.012
- Rogers, S. J. (2000). Diagnosis of autism before the age of 3. *International Review of Research in Mental Retardation*, 23, 1–31.
- Robins, D.L., Fein, D., Barton, M.A., & Green, J.A. (2001). The modified checklist for autism in toddlers: An initial study investigating the early detection of autism and pervasive developmental disorders. *Journal of Autism and Developmental Disorders*, 31, 131-144.
- Smith, B., Chung, M. C., & Vostanis, P. (1994). The path to care in autism: Is it better now? *Journal of Autism and Developmental Disorders*, 24(5), 551-563.
- Valicenti-McDermott M, Hottinger K, Seijo R, Shulman L (2012). Age at diagnosis of autism spectrum disorders. *The Journal of Pediatrics*, 161(3):554-556. doi: 10.1016/j.jpeds.2012.05.012
- Vostanis, P., Smith, B., Corbett, J., Sungum-Paliwal, R., Edwards, A., Gingell, K., Golding, R., Moore, A., & Williams, J. (1998). Parental concerns of early development in children with autism and related disorders. *Autism*, 2(3), 229-242.
- Werner, E., & Dawson, G. (2005). Validation of the phenomenon of autistic regression using home videotapes. *Archives of General Psychiatry*, 62(8), 889–895.
- Werner, E.B., Dawson, G., Osterling, J., & Dinno, N. (2000). Brief report: Recognition of autism spectrum disorder before one year of age—A retrospective study based on home videotapes. *Journal of Autism and Developmental Disorders*, 30, 157-162.
- Werner, E. B. & Munson, J. A. (2001). Regression in autism: A description and validation of the phenomenon using parent report and home video tapes. Poster session presented at the *biannual meeting of the Society for Research in Child Development*, Minneapolis, MN.
- Volkmar, F. R., Chawarska, K., & Klin, A. (2008). Autism spectrum disorders in infants and toddlers—An introduction. In K. Chawarska, A. Klin, & F. R. Volkmar (Eds.), *Autism spectrum disorders in infants and toddlers: Diagnosis, assessment and intervention* (pp. 1–22). New York: Guilford Press.
- Young, R., Brewer, N., & Pattison, C. (2003). Early behavioural abnormalities in children with autistic disorder. *Autism*, 7(2), 125-144.
- Zakian, A., Malvy, J., Desombre, H., Roux, S., & Lenoir, P. (2000). Early signs of autism: A new study of family home movies. *L'Encephale*, 26, 38-44.
- Zwaigenbaum, L., Bryson, S., Lord, C., Rogers, S., Carter, A., Carver, L., et al. (2009). Clinical assessment and management of toddlers with suspected autism spectrum disorder: Insights from studies of high-risk infants. *Pediatrics*, 123, 1383–1391.

Shtojcë: Pjesë e shkëputur nga pyetëtori

Informacion i përgjithshëm

Gjinia e prindit: Femër Mashkull

Mosha e prindërit: _____

Niveli i arsimimit: _____

Tetëvjecare

Gjimnaz

Bachelor (universitet)

Master

PhD

Tjetër (specifikoheni): _____

Gjinia e fëmijës: _____

Mosha e fëmijës: _____

Vendlindja: _____

Vendbanim: _____

Më poshtë janë disa pyetje në lidhje me fëmijën tuaj. Si e kujtoni ju periudhën kur tek fëmija juaj vutë re që diçka nuk shkonte:

2. A keni vënë re tek fëmija juaj vonesë së gjuhës së folur? (Vendos kryq ose +)

← Po (ju lutem shpjego)

Mosha (afërsisht): _____

← Jo

← Në cilën moshë, ju si prind jeni shqetësuar për të folurën e fëmijës tuaj? (Vendos kryq ose +)

1 vjeç

1,5 vjeç

2 vjeç

2,5 vjeç

3 vjeç

3,5 vjeç

4 vjeç

4,5 vjeç

5 vjeç

4. Vendosni përbri moshat e përafërta (1 vjeç; 1,5 vjeç; 2 vjeç; 2,5 vjeç, etj.) kur fëmija juaj realizonte:

← rrokje (për shembull: ma; ba; nëna): _____

← fjalor deri në 10 fjalë: _____

← fjalor deri në 10-50 fjalë: _____

fjali e thjeshtë me 3 fjalë: _____

lidhje mendimit 3-4 fjali të bashkuara: _____

MËSIMI I GJUHËS ANGLEZE NËPËRMJET TREGIMIT

ELONA ZIU

Doktorante, pranë Universitetit Europian i Tiranës.

Pedagoge e ftuar e gjuhës angleze pranë Univesitetit "Fan .S. Noli" Korçë

ABSTRAKT

Mësimi i gjuhës angleze është bërë domosdoshmëri për çdo qytetar të Evropës, si dhe të vendit tonë. Mësimdhënia e gjuhëve të huaja është një proces sfidues dhe me kërkesa për mësuesin. Në ditët e sotme mësuesit e gjuhëve të huaja përdorin një seri teknikash për një përvetësim sa më efektiv të gjuhës. Një teknikë që po rezulton shumë efikase është përdorimi i tekstit narrativ. Përdorimi i tekstit narrativ është një qasje e pranuar dhe e përdorur në mësimin e gjuhës angleze. Kjo teknikë përfaqëson një qasje holistike të mësimdhënies dhe të të nxënësve të gjuhës, bazuar në parimin se, nxënësit duhet të ndërveprojnë me shembuj të pasur, autentikë dhe të shumëllojshëm të gjuhës së huaj. Tregimet janë shumë motivuese, sfiduese dhe argëtuese. Pra, është e natyrshme për të mësuar gjuhën e huaj nëpërmjet tyre. Mësuesi përpiqet që, nëpërmjet tregimeve t'u mësojë nxënësve aspekte rreth gjuhës, jetës dhe kulturës. Adoleshentët, në qoftë se janë të angazhuar, kanë një kapacitet të madh për të mësuar një potencial të madh për krijimtari dhe një angazhim ndaj gjërave të cilat ngjallin interesin e tyre.

Ky studim bazohet në 300 pyetësorë të plotësuar prej nxënësve të shkollave të mesme të qytetit të Korçës, si dhe në 30 pyetësorë të plotësuar nga mësues të gjuhës angleze që japin mësim në shkollat e qytetit të Korçës. Studimi ka për qëllim të tregojë rëndësinë e tregimit në përvetësimin e gjuhës angleze.

Fjalë kyç: *teksti narrativ, nxënësit e shkollave të mesme, mësuesit e gjuhës angleze, përvetësimi i aftësive gjuhësore.*

Hyrje

Sipas Rebecca (2003), një tekst narrativ është një tekst, i cili lidh logjikisht, një seri ngjarjesh në mënyrë kronologjike të cilat kanë ndodhur ose janë përjetuar. Ajo, për më tepër, thekson se çelësi për të kuptuar një tregim është kuptimi i përmbajtjes, temës e karaktereve, të ngjarjeve, dhe se si ato lidhen. Përveç kësaj, Anderson dhe Anderson (2003) shpjegojnë se tregimi është një tekst që tregon një histori dhe, duke bërë kështu, argëton audiencën. Mësimi i gjuhës angleze është bërë domosdoshmëri për çdo qytetar të Evropës, si dhe të vendit tonë. Mësimi i gjuhës së huaj po shtrihet gjithnjë e më shumë në moshë më të vogla. Fëmijët që të vegjël mësojnë gjuhën e huaj, por njëkohësisht njihen më kulturën e huaj që më vonë në të ardhmen të rriten qytetarë më të ditur dhe më tolerant për kulturat e tjera. Mësimi i gjuhës së huaj që në këtë moshë kërkon që mësuesit të përdorin metoda mësimdhënie tërheqëse dhe të këndshme.

Mësimdhënia është një profesion i ndërlikuar edhe pse ajo mund të duket e lehtë për ata që s'merren me mësimdhënie. Një orë mësim i mirë dhe i suksesshëm nuk mund të quhet e tillë nëse merret e veçuar nga konteksti dhe u serviret nxënësve si një recetë për t'u ndjekur. Si mësues, disa pyetje të mëdha që na shqetësojnë janë: Si mund të bëhemi mësues më të mirë të nxënësve tanë? Si mund të lehtësojmë procesin e të mësuarit? Çfarë teknikash duhet të përdorim për ta kthyer praktikën në përvojë kuptimplotë?

Mësimdhënia e gjuhëve të huaja është një proces sfidues dhe me kërkesa për mësuesin. Një mësimdhënie e tillë kërkon mësues kompetentë në njohuritë e tyre linguistike dhe metodike, me aftësi krijuese në gjetjen, përshtatjen dhe prezantimin e materialeve mësimore dhe në përdorimin e teknikave që nxisin motivimin dhe mësimin e gjuhës së huaj. Në kohën e sotme mësuesit e gjuhëve të huaja përdorin një sërë teknikash për një përvetësim sa me efektiv të gjuhës. Një teknikë që po shikohet si shumë efektive është përdorimi i tekstit narrativ. Mësimdhënien e gjuhës angleze përmes tregimeve është një metodë tërheqëse për nxënësit. Përdorimi i tekstit narrativ është një qasje e pranuar dhe e përdorur në mësimin e gjuhës angleze në klasë. Ai përfaqëson një qasje holistike të mësimdhënies dhe të të nxënësve të gjuhës bazuar në parimin se nxënësit duhet të ndërveprojnë me shembuj të pasur, autentikë dhe të shumëllojshëm të gjuhës së huaj. Përdorimi i tekstit narrativ e vë theksin te përmbajtja dhe kuptimi. Ai plotëson atë boshllëk informacioni që kanë nxënësit duke i nxitur ata ta përdorin këtë informacion të ri në procesin e nxënies duke shfrytëzuar dhe njohuritë e tyre të mëparshme për të kuptuar tekstet autentike. Gjithashtu fokusi i mësimit bëhet procesi i të nxënësve se sa produkti i tij. Përdorimi i tekstit narrativ në mësimin e gjuhës së huaj i përfshin emocionalisht nxënësit. Historitë janë të këndshme jo vetëm për të vegjëlit, por edhe për të rriturit.

Përdorimi i tregimeve është metodë efektive, sepse nxënësit kanë një dashuri të lindur për to. Tregimet krijojnë magjinë dhe na mësojnë për jetën, për veten dhe për të tjerët. Tregimet në klasë krijojnë një lidhje të ngushtë midis mësuesit, dhe dëgjuesit, nxënësit. Mësuesi e personalizon tregimin për klasën, nxënësi ndjen se është i përkëdhelur sepse ky tregim është për të, në krahasim me tregimet në televizor, ose në radio, të cilat janë për një publik më të gjerë. Ky hulumtim fokusohet kryesisht në përdorimin e tekstit narrativ, ndihmën që i jep ai, nxënësit për të përvetësuar në mënyrë sa më të lehtë e natyrale gjuhën angleze. Ky humultim e sheh tekstin narrativ si një metodë mësimore që i kushton "vëmendje sistematike si aspektit strukturore ashtu dhe atij funksional të gjuhës, duke aftësuar nxënësin në përdorimin e drejtë të aftësive gjuhësore, pra në një përdorim korrekt të gjuhës ". Kjo qasje e vë më tepër theksin se si gjuha mund të përvetësohet në mënyrë sa më të lehtë, të këndshme, sesa qasjet e tjera të mësimdhënies .

Sipas Krashen, studentët mund të zhvillojnë aftësitë e një gjuhë të dytë ose duke mësuar, ose duke i përvetësuar ato. Mësimi është konsideruar si një proces i ndërgjegjshëm dhe vëmendja e studentëve është në strukturën e gjuhës .Ndërkohë, përvetësimi është parë si një proces i ngjashëm me atë të përvetësimit të gjuhës tonë amtare dhe përfaqëson një veprimtari të padërgjegjshëm duke vënë theksin mbi mesazhin. Përvetësimi është mënyra natyrale e mësimin të gjuhës së huaj. Krashen beson se aftësitë prodhuese (të folurit dhe të shkruarit) zhvillohen nga aftësitë e të dëgjuarit dhe lexuarit dhe, rrjedhimisht, atyre duhet t'u jepet shumë më tepër rëndësi. Ai beson se përvetësimi i një gjuhë të dytë arrihet më mirë përmes leximit. "Përvetësimi i gjuhës nuk kërkon përdorim të gjerë të rregullave gramatikore në mënyrë të ndërgjegjshëm, dhe nuk kërkon stërvitje të lodhshme." Stephen Krashen.Sipas tij përvetësimi kërkon ndërveprimin kuptimplotë në gjuhën e caktuar - komunikim natyror - në të cilën folësit nuk janë të shqetësuar për formën e thëniesve të tyre, por për mesazhet e përcjella dhe të kuptuarit." "Metodat më të mira për këtë arsye janë ato që të ofrojnë të dhëna të kuptueshme " në situata ankthi të ulëta, që përmbajnë mesazhe të cilat nxënësit vërtetë duan t'i dëgjojnë. Këto metoda nuk e ngutin riprodhimin e hershëm në gjuhën e dytë, por lejojnë nxënësit për të prodhuar kur ata janë 'gati', duke pranuar se përmirësimi vjen nga pajisja me të dhëna komunikuese dhe të kuptueshme, dhe jo duke detyruar riprodhimin e gjuhë apo duke korrigjuar vazhdimisht nxënësit. Përdorimi i tregimeve për të mësuar gjuhën angleze krijon një atmosferë mikpritëse në klasa dhe ndihmon mësuesit që të jenë mësues të një "shkollës cilësore" (quality school teachers).Sipas William Glasser dhe teorisë së tij të zgjedhjes(choice theory), mësuesi i shkollës cilësore, duhet të krijojë një mjedis të ngrohtë, mbështetës në klasë. Strategjia e tregimeve krijon këtë klasë të ngrohtë. Nxënësit ndihen mirë pasi ata janë pjesë aktive e mësimin dhe nuk e shohin mësuesin si lider por ata ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Duke përdorur tregime nxënësit mësojnë materiale të dobishme Ata nuk konkurrojnë, por ata bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.

"Adoleshentët, në qoftë se ata janë të angazhuar, kanë një kapacitet të madh për të mësuar, një potencial të madh për krijimtari, dhe një përkushtim të pasionuar ndaj gjërave të cilat ngjallin interesin e tyre. Nuk ka pothuajse asgjë më e emocionuese se një klasë në të cilën të rinjtë përfshihen e ndjekin mësimin me entuziazëm. Detyra jonë, është të provokojmë angazhimin e nxënësve me material interesante dhe gjithëpërfshirës. (Jeremy Harmer, 2005 dhe seanca Metodologjia) Përsëritja e shpeshtë lejon aspekte të caktuara gjuhësore për t'u fituar, ndërsa përforcon aspekte të tjera gjuhësore. "Shumë

histori përmbajnë përsëritjen e natyrshme e fjalorit dhe të strukturave kyçe. Kjo ndihmon nxënësit për të kujtuar çdo detaj, në mënyrë që ata mund të mësojnë gradualisht të parashikojnë se çfarë është gati të ndodhë më pas në histori. Përsëritja gjithashtu inkurajon pjesëmarrjen në tregim “. (Ellis dhe Brewster, 2002). Pse përdoren tregimet në mësimin e gjuhës së huaj? Ellis dhe Brewster (2002) japin disa arsye pse mësuesit duhet të përdorin tregime:

- ← tregimet pasurojnë përvojën e të mësuarit të nxënësve.
- ← Tregime janë motivuese dhe argëtuese dhe ndihmojnë të zhvillojnë qëndrime pozitive ndaj gjuhëve të huaja.
- ← Tregimet të ushtrojnë imagjinatën dhe janë një mjet i dobishëm në lidhjen fantazi dhe imagjinata me botën e vërtetë të fëmijës
- ← Dëgjimi i tregimeve në klasë është një përvojë e përbashkët sociale.
- ← Fëmijët gëzojnë duke dëgjuar tregime.
- ← Dëgjimi i tregimeve zhvillon të dëgjuarit e fëmijës dhe aftësinë për t’u përqëndruar.
- ← Tregime krijojnë mundësi për zhvillimin e vazhdimësisë në të nxënësit e fëmijëve

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i mësimit të gjuhës së huaj është që nxënësi të jetë i aftë ta përdorë, kuptojë e riprodhojë gjuhën e huaj në mënyrë sa më efektive dhe në kontekstin e duhur, si dhe të ndërveprojë duke përdorur gjuhën e huaj në mënyrë sa më korrekte. Në ditet e sotme qëllimi i mësimdhënies është pajisja e nxënësve me teknika të të nxënës, nxitja e tyre për të qenë sa më aktive dhe në qendër të orës së mësimit. Ky studim synon të trajtojë motivimin, ndihmesën dhe krijimin e një qëndrimi pozitiv ndaj mësimit të gjuhës së huaj realizuar nga përdorimi i tekstit narrativ në mësimin e gjuhës së huaj. Ky studim ka si qëllim të përshkruajë dhe analizojë një sërë veprimtarish që përdoren gjatë mësimdhënies duke përdorur tekstin narrativ dhe që mundësojnë vënien e nxënësit në qendër të mësimit nëpërmjet përfshirjes së tij në veprimtari të shumëllojshme, në një kontekst sa më natyral e familjar ku stimulohet interesi i nxënësit për përdorimin e gjuhës së huaj duke shfrytëzuar tekste autentike. Ky studim ka për qëllim të evidentojë qëndrimin e nxënësve dhe mësuesve ndaj përdorimit të tekstit narrativ në orën e gjuhës angleze.

Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Ky studim parashtrohet këto hipoteza:

- 1- Përdorimi i tekstit narrativ nxit përdorimin e qasjes (teorinë) konstruktive në klasë.
- 2- Nxënësit përvetësojnë më shpejt aftësitë gjuhësore. (leximin, dëgjimin, shkrimin, të folurën)
- 3- Përdorimi i tekstit narrativ motivon nxënësit të përdorin gjuhën në kontekste autentike dhe reale.
- 4- Përdorimi i tekstit narrativ krijon një lidhje emocionale midis gjuhës dhe nxënësve.

Bazuar në rëndësinë e përdorimit të tekstit narrativ në klasë, të mësuarit e aftësive të duhura gjuhësore, gjithashtu dhe në zhvillimin e aftësive gramatikore, ky studim përpaket t’i përgjigjet kësaj pyetjeje: “Si stimulon teksti narrativ pjesëmarrjen e nxënësve në mësimin e gjuhës angleze, për një përvetësim sa më të mirë të aftësive gjuhësore ? “Çështjet që do të trajtohen janë si më poshtë:

- 1- Si ndryshon niveli i përvetësimit të aftësive gjuhësore kur përdoret teksti narrativ duke e krahasuar me metodat e tjera të mësimdhënies?
- 2- Cilat teknika përdoren dhe cilat janë më efektive për nxitjen e përfshirjes së nxënësve?
- 3- A është metoda e përdorimit të tekstit narrativ më efektive se metodat tradicionale?

Metodat që u përdoren janë si më poshtë

Studimi i literaturës përkatëse

Informacioni që u përdor për këtë studim përfshin kërkimin shkencor në botime të ndryshme, në internet, kërkime eksperimentale të aplikuar në shkollat e mesme, botime autorësh të ndryshëm të huaj dhe vendas mbi ndikimin që ka teksti narrativ për një përvetësim sa më të mirë e efektiv të gjuhës angleze, gjatë orës së mësimit. U analizuan literatura shkencore për këtë temë. U përcaktuan subjektet e studimit, kampionet, metodat kërkimore, instrumentet e studimit, procedura e mbledhjes dhe e analizës së të dhënave.

Kampionet e studimit

Grupet e studimit u morën nga nxënësit e shkollave të qytetit Korëë dhe si dhe nga mësues të shkollave të këtij qyteti.
 ← mblodhën të dhëna me anë të pyetësorëve dhe intervistave, që kishin si qëllim mbledhjen e informacionit mbi bindjet, qëndrimet dhe njohuritë e mësuesve të gjuhëve të huaja dhe nxënësve për përdorimin e tekstit narrativ, nëpërmjet intervistave do të identifikohen dhe nxirren konkluzione për teknikat dhe strategjitë e të nxënësve efektiv.

Instrumentet e kryerjes së studimit

Pyetësorët përfshijnë një kampion prej 300 nxënësish dhe mësuesish. Ata mundësuan mbledhjen e të dhënave sasiore. Interpretimi i këtyre të dhënave u vu në funksion të hipotezave të ngritura në fillim. Qëllimi i pyetësorit ishte: Pyetësorë për mësuesit për përdorimin e tekstit narrativ gjate ores se mesimit dhe për qëndrimin e nxënësve ndaj veprimtarive në lidhje tekstin narrativ. Pyetësorë për nxënësit ç'mendim kanë për përdorimin tekstit narrativ dhe llojet e teksteve që atyre iu pëlqen më shumë. Vëzhgime të mësimëve të zakonshme dhe mësimëve model ku u përdoren aktivitete të ndryshme përdorimit të tekstit narrativ.


Analizë, interpretim të dhënash

300 pyetësorë u plotësuan nga nxënësit e shkollave të qytetit të Korçës. Pyetësori ishte i ndarë në 2 pjesë: pjesa e parë kishte pyetje në lidhje me leximin në gjuhë të huaj dhe pjesa e dytë pyetje rreth tekstit narrativ.


Çfarë marrëdhënie kanë me literaturën në gjuhën angleze?




Leximi juaj bazohet në :




Sa shpesh lexoni në gjuhën angleze?




Çfarë lexoni më shumë?




A hasni vështirësi në kuptimin e materialit që lexoni?




Cila është vështirësia kryesore që hasni?



Gjatë leximit të materialit në gjuhën angleze




Leximi materialeve ju ndihmon në përvetësimin e gjuhës angleze?




Nga të dhënat e marra nga pyetësori duket qartë se nxënësit pëlqejnë të lexojnë në gjuhën angleze dhe ata kryesisht pëlqejnë tregimet dhe artikujt. Leximi i literaturës së shkruar është ajo çka shumica e nxënësve, që lexojnë në gjuhën angleze, preferon. Por shihet se dhe leximi virtual pëlqehet dhe sa vjen dhe po shfrytëzohet nga të gjithë nxënësit. Nxënësit u shprehën se vështirësitë që hasin janë kryesisht në kuptimin e fjalorit, por gjatë leximit ata mundohen të gjejnë kuptimin e fjalëve nëpërmjet kontekstit. Kjo gjë i ndihmon për një të kuptuar më të lehtë të gjuhës angleze. Shumica e tyre u shpreh se leximi i ndihmon shumë në përvetësimin e gjuhës angleze.

Pyetje në lidhje me tekstin narrativ


Të pëlqen të lexosh tregime në gjuhën angleze?




Punoni me tregime gjatë orës së mësimin të gjuhës angleze?




Tregimet që përdorni gjatë orës së gjuhës angleze ju ndihmojnë të përforconi




A është e vështirë gjuha e përdorur në këto tregime?




Veprimtaritë që përdor mësuesi gjatë orës së mësimit kur përdoret tregimi, si mendoni ju përfshijnë më shumë në krahasim me orët e tjera mësimore kur nuk përdoret tregimi?



Si mendoni përdorimi i tregimit në orën e anglishtes:



Nga përdorimi i tregimit, a ju shtohet dëshira për të lexuar në gjuhën angleze?



Në bazë të përgjigjeve që u morën nga pyetësi vihet re se nxënësit e pëlqejnë tregimin si metodë të përdorur gjatë orës së mësimi të gjuhës angleze. Gjithashtu ata shprehën se tregimi përdoret shpesh nga mësuesit e tyre.

Sipas të dhënave të pyetësit dhe mendimit të shprehur nga nxënësit tregimi gjatë orës së mësimi i ndihmon ata të përvetësojnë jo vetëm fjalorin, por dhe strukturat gramatikore. I aftëson nxënësit të shprehën më mirë në gjuhën angleze, ta përdorin gjuhën në mënyrë më të natyrshme. Pra i ndihmon në përvetësimin e të katër aftësive gjuhësore (e folura, e shkruara, e dëgjua dhe leximi). Megjithatë vlen për t'u theksuar se një pjesë e mirë e nxënësve janë shprehur se gjuha e përdorur në këto tregime është e vëshitirë. Kjo lidhet me nivelin e tyre gjuhësor dhe përgatitjen e tyre, si dhe me përshtatjen e tregimit me secilën grupmoshë.


Nxënësit janë shprehur se pëlqejnë veprimtaritë që përdoren gjatë orëve kur mësuesit përdorin tregimin si metodë mësimdhënieje. Ata ndihen më të përfshirë në karhasim me orët e tjera ku nuk përdoret tregimi. Ata ndihen më të motivuar dhe duket qartë nga të dhënat e pyetësit se tregimet ua shton dëshirën për të lexuar në gjuhën angleze pasi i njeh me aspekte kulturore dhe historikë të vendeve të tjera si dhe gjuha dhe situatat i përkasin një konteksti real.

Pyetësi i mësuesve

Konstruktivizmi është një qasje e të mësuarit e bazuar në besimin se njohuria nuk është një gjë shabllon që mund t'u jepet nxënësve vetëm nga mësuesi dhe se mësuesi nuk është i vetmi burim informacioni. Përkundrazi, dija ndërtohet nga nxënësit përmes një procesi zhvillimi aktiv, mendor; nxënësit janë ndërtuesit dhe krijuesit e kuptimit dhe të diturisë. Mësimdhënia konstruktiviste është e bazuar në besimin se të mësuarit ndodh kur nxënësit janë të përfshirë në mënyrë aktive në procesin e kuptimit dhe të ndërtimit të dijes dhe nuk janë pasivë në marrjen e informacionit. Nxënësit janë krijuesit e kuptimit dhe diturisë. Mësimdhënia konstruktivist nxit mendimin kritik i motivon, nxënësit të jenë të pavarura. Një mësues konstruktivist dhe një klasë konstruktiviste ndryshojnë nga një klasë tradicionale në disa mënyra. Në klasën konstruktiviste nxënësit janë interaktive dhe nxënësin janë në qendër të procesit mësimor; mësuesi lehtëson procesin e të mësuarit në të cilin, nxënësit inkurajohen që të jenë përgjegjës dhe autonom. Tregimet i ndihmojnë mësuesit që të jenë mësues konstruktivistë dhe klasa të jetë një vend ku të mësuarit me të vërtetë ndodh. Në ditët e sotme, qëllimi i mësuesve është që të rrisë motivimin, dhe gjithashtu të nxisë qëndrimin pozitiv ndaj të mësuarit e një gjuhe të huaj dhe krijimin e një atmosfere të ngrohtë në klasa. Mësuesit e anglishtes përpiqen shumë për të bërë nxënësit të përdorin gjuhën në kontekste reale dhe të fitojnë vetëbesimin në përdorimin e gjuhës së huaj. Ata përdorin një numër aktivitetesh dhe mjeteve që mundësojnë përfshirjen e nxënësve në këto aktivitete, të cilat stimulojnë interesin e tyre për të komunikuar duke përdorur gjuhën angleze. Mësuesit përdorin një shumëllojshmëri metodash bashkëkohore të mësimdhënies, duke e bërë mjedisin e klasës një vend ku nxënësit janë të motivuar, e të stimuluar, e i bëjnë të ndihen të qetë duke i bërë ata aktorët e mësimdhënies në klasë të - procesin e të mësuarit.

30 mësues të shkollave të qytetit të Korçës plotësuan pyetësonin. Mësuesit ishin të moshës 25-30 vjeç me eksperiencë në punë nga 5-15 vite. Pyetësoni kishte 11 pyetje të cilat mësuesit u janë përgjigj: Po, Jo, ose Nuk Komentoj.

■ P0 ■ Jo ■ Nuk komentoj



Duke analizuar të dhënat e pyetësorit vihet re se shumica e mësuesve e vlerësojnë dhe përdorin tregimin si një strategji bashkëkohore të mësimdhënies. Mësuesit e vlerësojnë si një metode efikase për mësimin e gjuhës angleze. Tregimet, sipas tyre, i ndihmojnë nxënësit të përvetësojnë më lehtë strukturat gramatikore si dhe kompetencat gjuhësore. Tregimet luajnë një rol të rëndësishëm dhe në njohjen e vlerave kulturore e historike të vendeve të ndryshme, si dhe njohjen e aspekteve historike të gjuhës angleze. Nëpërmjet tregimit mësuesit mund të përdorin një sërë metodash bashkëkohore si psh. stuhia e mendimeve, fjalët kyçe, pyetje përgjigje, si dhe mundëson një ndërveprim të nëxënësve në situata reale. Gjithastu mësuesit e përdorin tregimin për të kontrolluar njohuritë gjuhësore të nxënësve. Ata kanë shprehur mendimin se tregimi rrit dëshirën për të lexuar në gjuhën angleze si dhe më shumë tregime duhet të përfshihen në tekstet mësimore të gjuhës angleze.

Vëzhgime të mësimave të zakonshme dhe mësimave model ku u përdoren aktivitetet të ndryshme përdorimit të tekstit narrativ. Vëzhgimet e orëve të mësimin u bënë në klasa të ndryshme (shkolla 9 vjeçare dhe të mesme). Klasat u zgjodhën në mënyrë rastësore dhe numri i nxënësve nëpër klasa ishte nga 25- 35. Gjithashtu dhe niveli i nxënësve nëpër klasa ishte i ndryshëm. Kishte nxënës me një nivel shumë të mirë të anglishtes, nxënës me një nivel mesatar si dhe nxënës me një nivel të ulët të anglishtes.

Gjatë vëzhgimit të orëve model të mësimin u vu re se nxënësit ndiheshin më të angazhuar. Ndihehin më të lirshëm. Tregimi i mundëson ata të përfshiheshin në aktivitetet të ndryshme. Aktivitetet ishin të larmishme dhe nxënësit të cdo niveli mund të përfshiheshin. Roli i mësuesit, ishte roli i një bashkëbiseduesi. Mësuesi luante rolin e lehtësuesit të procesit të mësimin, ai menaxhonte atë por ishin nxënësit që e drejtonin dhe ishin ata që ishin pjesëmarrësit kryesor. Mësuesi nxiste iniciativën e nxënësve. Në aktivitetet që mësuesi iu jepte nxënësve ai përdorte folje si klasifiko, krijo, analizo të cilat nxënësit dhe shfrytëzonin pontecialin e tyre gjuhësor. Nxënësit liheshin të lirë të sugjeronin si dhe të ndryshonin rrjedhën e mësimin me aktivitetet ku ata merrnin pjesë. Ata ndiheshin të lirë të shprehnin mendimin e tyre të ndanin eksperiencat me njëri-tjetrin. Nxënësit përfshiheshin në dialogje me njëri-tjetrin si dhe ndonjëherë dhe me mësuesin, mësuesi ishte bashkëpunëtor me nxënësit dhe nxënësit ndiheshin si pjesë e një skuadre. Disa nga veprimtaritë që mësuesit përdorin janë si më poshtë. Të gjithë mësuesit përdorin aktivitetet para leximit, gjate leximit dhe pas leximit. Këto aktivitetet janë si më poshtë: stuhi mendimesh, harta e mendimeve, çfarë di, çfarë do të dish dhe çfarë mësove, fjalët kyçe, pyetje përgjigje rreth tregimit, insert, dramatizime, ese, shkrim i lirë, pesëvargëshin, dialogje etj. Por ajo që vlen të theksohet është se ata pëlqenin të vazhdonin tregimet të ndryshonin si dhe të shkruanin mbi eksperiencat e tyre. Tregimet i ndihmonin shumë për të përdorur aftësitë gjuhësore. Tregimet lejonin që të gjithë nxënësit të ishin pjesëmarrës në mësim.

Nëpërmjet tregimeve nxënësit përvetësonin aspektet gramatikore si p.sh: kohët e foljeve, fjalitë kushtore, ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë, forma joveprore, lidhëzat dhe konektorët kohorë, fjalorin, kryesisht ndajfoljet, mbiemrat, strukturën e gjuhës angleze –rendin e fjalëve, shprehje frazale, idioma, shprehjet ndajfoljore etj. Vlen të theksohet se tregimet dhe leximi i tyre nxit imagjinatën dhe mendimin kritik. Shpalo paratyre një botë të re, që ndoshta ata e përfytyrojnë të huaj por që kur e prekin përmes tregimit, shohin që është një botë si e njëjtë me botën e tyre. Nëpërmjet përsëritjes së fjalëve dhe strukturave gjuhësor nxënësit i përvetësonin më lehtë ato. Në karahasim më një orë tjetër mësim ku nuk përdorej tregimi, nxënësit e kishin më të lehtë të mbanin mend rregullat gramatikore psh. se vetës së 3 njëjës që është një nga gabimet më të shpeshta të nxënësve kur mësohej nëpërmjet tregimit përdorej më drejt e saktë nga nxënësit.

Tregimet u mundësonin gjithashtu mësuesve të shfrytëzonin dhe materiale të ndryshme didaktikë si psh. flash cards, foto dhe dërrasën intraktive ku shfaqej një tregimin dhe nxënësit kryenin aktivitetet rreth tij etj. Ajo çka ishte dhe më e rëndësishme ishte se nxënësit shfaqnin interes për të dëgjuar e marrë pjesë në aktivitetet, ishin më aktiv gjatë mësimin. Problemet e vërejtura ishin se disa herë gjuha e përdorur ishte e vështirë dhe tregimi duhej realizuar gjatë një ore mësimi. Ndonjëherë numri i madh i nxënësve e bënte të vështirë që të flisnin të gjithë. Megjthatë puna në grupe i mundëson të përfshiheshin më shumë, karahasur me një orë tjetër.

Konkluzione

Në ditët e sotme përvetësimi i anglishtes është një domosdoshmëri, dhe duke i mësuar nxënësit në mënyrën më efektive është një domosdoshmëri. Kjo është detyrë e mësuesit për të lehtësuar procesin e të mësuarit dhe t'i bëjë nxënësit të përvetësojnë gjuhën dhe ta përdorin atë në mënyrë efikase. Kombinimi i teknikave të ndryshme dhe teknika të adoptuar për mësim është ajo që shumica e mësuesve kërkojnë. Tregime janë parë si metodë shumë interesante dhe efektive të mësimdhënies.

Të gjithë mësuesit ishin dakord se tregimet duhet të përdoren më shumë dhe ata mendojnë gjithashtu se programi shkollor kombëtar shqiptar (kurrikula) duhet të përfshijë një tjetër orë mësimore që lidhet me leximin dhe që i jep nxënësve një mundësi për të praktikuar anglisht. Në kohën e sotme kur rëndësia e gjuhës angleze sa vjen dhe bëhet më e madhe është detyra e mësuesve të gjejnë mënyra për të motivuar e nxitur nxënësit për të mësuar gjuhën angleze. Gjithashtu është detyra e tyre të gjejnë mënyra e strategji ta lehtësojnë mësimin e gjuhës angleze. Nga sa u vërejt nga të dhënat e pyetësorëve të mësuesve dhe atyre të nxënësve, përdorimi i tregimit në orën e mësimin të gjuhës së huaj vlerësohet si një strategji bashkëkohore e cila realizon përvetësimin e gjuhës në mënyrë efikase dhe mundëson përdorimin e saj nga ana e nxënësve. Si nxënësit ashtu dhe mësuesit mendojnë se tregimi është një strategji mësimore mjaft efikase. Është një strategji e realizueshme në të gjitha klasat si në ato të ciklit të ulët dhe në ato të ciklit të lartë, e realizueshme në të gjitha shkollat qoftë kjo në periferi, qendër të qytetit apo në shkollat në fshat. Është një strategji që vë në qendër nxënësin, dhe e lejon mësuesin të shfrytëzojë kapacitetet e tyre. Është një mënyrë ose strategji e cila kërkon përkushtim. Tregimet janë të dashura nga nxënësit e të gjitha grupmoshave. Do

të ishte shumë mirë që tregimeve t'u lihej një vend të veçantë në kurrikulën e shkolla. Përdorimi i tij ndihmon nxënësin të fitojë vetëbesim në përdorimin e gjuhës së huaj dhe në mënyrë që nxënësit të aftësoheshin në një përdorim komunikativ të gjuhës angleze dhe i nxit mësuesit të përdorin tekstin narrativ si një metodë bashkëkohore duke krijuar një mjedis ku nxënësi të jetë në qendër të procesit të mësimdhënies dhe përvetësimi i aftësive gjuhësore të bëhet në mënyrë sa më natyrale dhe të lehtë për nxënësit.

Bibliografia

- Balliet, B and Helquist (2007) "The Wright 3" Scholastic
- Bal, M. (1985) "Narratology introduction to the theory of narrative" University of Toronto Press
- Bruner, J. (1997) "The culture of education" Harvard University Press
- Dewey, J. (1997) "Experience and Education" Touchstone
- Downie, M- Jimene, J.M (2008) "Elevator 4" by Richmond Publishing
- Dibra, K and Varfi, N (2008) "Gjuhesi Teksti" Albatros
- Ellis, G and Brewster, J (2002) "Tell it Again! The Storytelling Handbook for Primary English Language Teachers" Pearson
- Longman Glasser, W (1992) "The quality school teacher" HarperPerennial
- Haven Kendal, F (2000) "Super Simple Storytelling" Teachers Ideas Press
- Jeremy Harmer, 2005 "The practice of language teaching" Pearson
- Longman Karameta, P. (2014) "Arsimi i Gjenerates Tjeter" Sara
- Krashen, S. (1981). Second Language Acquisition and Second Language Learning. Oxford: Pergamon Press
- Krashen, S. (1982). Principles and Practice in Second Language Acquisition. Oxford: Pergamon Press
- Krashen, S. (1985). Input Hypothesis. Harlow: Longman.
- Micheal, F. (2005) Fundamental change. Springer
- Lévi-Strauss, (1966) "Savage minds" Librairie Plon (Paris)
- Rebecca, J. L. (2003). A Critical Handbook of Children's Literature. Massachuset: Pearson
- Education, Vygotsky (1980) "Mind in society" Harvard University Press
- Williams et al., "The Art of Storytelling")
- Wikipedia

ROLI, MISIONI, FUNKSIONET DHE PËRGJEGJËSITË E MËSUESIT KUJDESTAR TË KLASËS NË SISTEMIN E SOTËM TË ARSIMIT SHQIPTAR

LINDITA TRESKA

Doktorant, Kolegji "New York", Tiranë

PROF.ASOC.DR TOMI TRESKA

Universiteti European i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, Departamenti i Edukimit, Tiranë

ABSTRAKT

Punimi është një studim teoriko-empirik që ve në qendër mësuesin kujdestar shqiptar. Punimi paraqitet modelin që ndjek sot arsimit shqiptar në përcaktimin e rolit, misionit, funksionit dhe përgjegjësisë të mësuesit kujdestar. Mësuesi kujdestar ka një rol të rëndësishëm që nga klasa e parë deri në të dymbëdhjetën. Ai është një mësues i shkollës, një nga mësuesit lëndorë të klasës i cili ngarkohet të kujdeset për një klasë të caktuar për ta ndihmuar atë në punën mësimore dhe edukative. Mësuesi kujdestar përkujdeset posaçërisht për të krijuar atmosferë mirëkuptimi dhe bashkëpunimi mes nxënësve; për nxënësit me aftësi të kufizuara, nxënësit me vështirësi në të nxënë, për të sapoardhurit dhe për ata me shqetësime të sjelljes; frekuentimin e shkollës nga nxënësit; për plotësimin e kurrikulës me zgjedhje; kujdeset që nxënësit të mos mbingarkohen; që t'i këshillojë nxënësit edhe në zgjedhjet e karrierës.

Punimi hedh hipotezën se kërkesat e sotme dhe trendet e zhvillimit të arsimit në Shqipëri kërkojnë ridimensionimin e rolit të mësuesit kujdestar, së pari duke rishqyrtuar teorinë e edukimit në të cilën mbështetet ky konceptim. Për këtë punim janë studiuar teoritë kryesore të edukimit sot në botë si dhe gjithë dokumentacioni themelor ligjor dhe nënligjor aktual shqiptar. Kjo analizë teorike pasohet me intervista të drejtpërdrejta me drejtues shkollash dhe mësues kujdestarë të institucioneve të arsimit 9-vjeçar dhe gjimnaze.

Fjalë kyç: mësues kujdestar, nxënësit e klasës, këshilli i prindërve të klasës, koordinator, edukim qytetar, teori edukimi.

Disa teori kryesore të edukimit

Sot mendimi pedagogjik është ndarë përsa i përket subjektit të arsimit. “Prapa çdo shkolle e çdo nxënësi është një numër bindjesh - një filozofi që ndikon, se çfarë dhe si duhen mësuar nxënësi. Këto bindje ose filozofi lidhen direkt me pyetjet e metafizikës, epistemologjisë dhe aksiologjisë: Ç’është realiteti? Si e njohim ne? Ç’është me vlerë?” (Sadker Pollack Myra, Sadker Miller Davis, 1995:243).

Përgjigjet e këtyre pyetjeve formojnë bazat e filozofive të ndryshme arsimore, pesë prej të cilave janë: Esencializmi, i cili përqëndrohet në dhënien e dijeve që janë esenciale për qytetarë prodhimtarë. Esencializmi beson në një bërthamë të fortë njohurish dhe standarde të larta akademike. (Sadker Pollack Myra, Sadker Miller Davis, 1995:243). Perencializmi, filozofia që beson se të vërtetat universale ekzistojnë dhe se arsimit duhet të jetë proces i studimit të këtyre të vërtetave përmes një serie librash të mëdhenj (që mbështetet në idenë se studimi i veprave të mendimtarëve drejtues të Qytetërimit Perëndimor është rruga më e mire për një arsim të përgjithshëm). (Sadker Pollack Myra, Sadker Miller Davis, 1995:243). Në të kundërt, Progresivizmi, beson se dijet janë përherë në ndryshim, dhe, për pasojë trajtimi më i mire i arsimit do të ishte përvetësimi i shkathtësive problemzgjdhëse përmes zbulimit dhe eksperimentimit. (Sadker Pollack Myra, Sadker Miller Davis, 1995:243). Filozofia e Ekzistencializmit, beson se nuk ekziston realitet universal, përkundrazi realiteti është ai ç’ka percepton nxënësi. (Sadker Pollack Myra, Sadker Miller Davis, 1995:243). Filozofia e Bihevizmit beson se bota fizike është e vetmi realitet dhe se njerëzit reagojnë ndaj stimuljeve të jashtëm. (Sadker Pollack Myra, Sadker Miller Davis, 1995:243).

Në një shkollë të bazuar mbi secilën prej këtyre filozofive arsimore, apo kombinimit të tyre, mësuesit strukturojnë ambientin për të stimuluar direkt të mësuarin. Këto filozofi gjejnë zbatim në mënyrën se si zhvillohet një sistem arsimor i caktuar, apo vetë shkolla, si perceptohen programet, si mësohen nxënësit dhe se ç’lloj mësuesi duhet “të prodhojmë”. Për një popull zgjedhja e sistemit të edukimit është më e rëndësishme se zgjedhja e qeverisë. (Sadker Pollack Myra, Sadker Miller Davis, 1995:243).

Gjithsesi sistemet arsimore gjithnjë kanë funksionuar duke patur një mision qytetarës. Formimi i qytetarit rezulton në edukimin që njeriu merr në shkollë dhe në të gjitha përvojat e tjera që merr nga jeta. Do të thotë se qytetari formohet, edukohet, kultivohet gjatë gjithë jetës. Këshilli i Evropës i ka dhënë rëndësi prioritare Edukimit për Qytetarinë Demokratike (EQD). EQD-ja ka rëndësi kyçe për të garantuar që gjeneratat e ardhshme të qytetarëve të rinj të jenë të përgatitur dhe të aftësuar të luajnë rolin e tyre demokratik në komunitetin e tyre, në shoqërinë e tyre më të gjerë dhe në kuadër të Evropës në tërësi. (Backman, E., & Trafford, B 2007:4) Shkolla ka detyrimin t’i njohë dhe përgatisë nxënësit me mënyrën demokratike të jetesës. Në librin e tij Adem Tamo vë në dukje hipotezën e ndërhyrjes së hershme formuese, që është zbatuar dhe zbatohet në mënyrë më të plotë në sistemin arsimor. “Dy modelet më të përparura të ndërhyrjes së hershme për formimin e qytetarit janë:

- ← Ndërhyrja me anë të lëndëve të posaçme si Edukata morale, Edukata qytetare, Edukata politike etj.
- ← Ndërhyrja me anë të gjitha lëndëve të tjera, sidomos me anë të lëndëve të drejtëpërdrejta shoqërore, si historia, letërsia, sociologjia etj.
- ← Ekziston edhe modeli i shkollës amerikane e cila ndjek një rrugë të tretë të formimit të qytetarit që di t’ia përshtatë traditën dhe vlerat situatave shoqërore që ndryshojnë” (Tamo,1999:3).

Këto tri modele arsimore për formimin e qytetarit janë përpunuar dhe pasurohen vazhdimisht. Në praktikën e përditshme të punës mësimore trinomi edukim – arsimim – formim, përbën themelin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies aktive, kritike dhe gjenerativo – ndryshuese. Si duhet të kuptohet kjo? Pra si duhet kuptuar nëse një veprimtari është dhe duhet të jetë edukim, arsimim ose formim? Kujt i takon parësia? A nuk është vallë edukimi edhe arsim edhe formim? Po arsimi a nuk edukon e formon? Nëse nuk janë e njëjta gjë, a është e mundur të përfshihet arsimi tek edukimi e tek formimi e anasjelltas?

Edukimi i drejtohet sidomos fushës së reflektimit të vlerave, afektiv–relacionale, etiko–shoqërore, duke u shtjelluar e realizuar kryesisht në institucionet joformale si familja, shoqatat e lira, përveçse në shkollë.

Ndërsa arsimi, si koncept e proces, i drejtohet fushës së konjiktives dhe proceseve të përfitimit të njohurive, dijeve dhe kompetencave. Ai shtjellohet dhe realizohet kryesisht në institucione formale e sidomos në shkollë, vend i specializuar i proceseve të të mësuarit, e të nxënës, të trashëgimisë së kulturës e kërkimit personal, ndër të tjera, pikë referimi e gjithë sistemit të edukimit.

Së fundi, formimi shihet si një proces dinamik i “të përfuturit të formës” dhe i “të formuarit”, si dimension ku realizohet integrimi kritik dhe konstruktiv i lidhjes (së ndërthurur e dialektike) edukim – arsim” (Franco Frabboni, Franca Pinto Minerva, 2003:148). Natyra e marrëdhënies dhe gërshetimit ndërmjet dimensioneve të edukimit-arsimit-formimit ka qenë në qendër të reflektimit pedagogjik dhe sipas metodave teorike ka argumentuar arsyet pse një dimension kryeson mbi të tjerat.

Modeli i shkollës shqiptare

Didaktët kanë rënë dakord, se të mësuarit është procesi i përvetësimit të arsimit e bashkë me të edhe i një edukate të caktuar. (Dibra, G & Taipi, M & Halluni, E. 2013:13).

Sipas mendimit tim, filozofia që përfaqëson shkollën shqiptare mbi arsimin është një ndërthurje e disa filozofive: e Perencializmit, Ekzistencializmit, Bihevizmit dhe Progresivizmit.

Veçanërisht filozofia Progresiviste gjen fushë zbatimi më të gjerë në arsimin shqiptar. Ky mendim buron mbas analizës së thelluar e krahasuese mes filozofive të sipërmendura dhe kuadrit ligjor të arsimit parauniversitar shqiptar, kryesisht të Dispozitave Normative që janë aktualisht në fuqi në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës-MASH (sot Ministria e Arsimit dhe Sporteve-MAS) në vitin 2013. Në nenin 84 të Dispozitave Normative “Mësuesi kujdestar i klasës”, përkatësisht në pikat 3, 4 dhe 6, theksi vihet më së shumti në raportet e ndërtimit të marrëdhënieve bashkëpunuese që vendos mësuesi kujdestar me nxënësit, psikologun, punonjës social, këshillin e prindërve të klasës, mësuesit që zhvillojnë mësim në klasën e tij të kujdestarisë, qeverinë e nxënësve, etj. Ky bashkëpunim eliminon rolin e tij autoritarist siç deklarohet në fakt shkollat tradicionale (Perenializmi, Esencializmi), sipas të cilave në qendër vendosej mësuesi dhe ku vendimmarrja për çdo aspekt lihet në dorë të tij. Fryma e bashkëpunimit bën të mundur ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi në interes të së mirës së përbashkët.

Po në këtë nen, pika 1, 2 dhe 4 “Mbi bashkëpunimin e mësuesit kujdestar me prindërit”, shpaloset sërish filozofia progresiviste e cila e vendos mësuesin si një udhërrëfyes në zgjidhjen e problemeve dhe në planifikimin e veprimtarive, e cila duhet të realizohet së bashku mësues-nxënës-prindër.

Çfarë duhet kuptuar me “Mësues kujdestar i klasës”?

Sot ekzistojnë disa tipa (lloje) të Mësuesit kujdestar (“The class teacher at the school: roles, responsibilities, work system”; <http://paidagogos.com/?p=7836#>)

- ← Mësues lënde, i cili njëkohësisht kryen dhe detyrën e mësuesit kujdestar.
- ← Mësues kujdestar, i liruar nga punët e tjera të veprimtarisë mësimdhënëse, që bën vetëm punën edukative me nxënësit e klasës.
- ← Kurator i klasës i cili kuron një lloj pune të caktuar në klasë.
- ← Tutor, mbrojtës (përkrahës) i klasës, ose një drejtues i nxënësve të klasës për të plotësuar një veprimtari të përcaktuar paraprakisht.

Në Shqipëri gjejmë të zbatuar tipin e parë të mësuesit kujdestar, pra mësuesin e lëndës, i cili njëkohësisht kryen edhe detyrën e mësuesit kujdestar.

Sipas Dispozitave Normative 2013, Mësuesi kujdestar i klasës është një mësues i shkollës, një nga mësuesit lëndor të klasës, i cili ngarkohet që të kujdeset për një klasë të caktuar për ta ndihmuar atë gjatë gjithë vitit shkollor në punën mësimore dhe edukative. Mësuesi i ciklit fillor është mësuesi kujdestar i klasës së tij. Mësuesi kujdestar është mësuesi më i afërt i nxënësve të klasës.

Roli i mësuesit kujdestar klase sot në Shqipëri

Sipas Nenit 84 të Dispozitave Normative - Mësuesi kujdestar ka një rol të rëndësishëm që nga klasa e parë deri në klasë të dymbëdhjetë. Mësuesi kujdestar i klasës caktohet nga drejtori i shkollës për çdo klasë jo më vonë se 5 ditë para datës së fillimit të mësimave të vitit shkollor dhe për mësuesit e rinj kujdestar, jo më vonë se 15 ditë para fillimit të vitit shkollor.

Veprimtaria e mësuesit kujdestar të klasës është e gjerë dhe e shumanshme. Mësuesi kujdestar përkujdeset posaçërisht:

- ← të krijojë atmosferë mirëkuptimi dhe bashkëpunimi në mes nxënësve me njëri-tjetrin brenda klasës, me nxënësit e tjerë të klasave paralele, më nxënësit e klasave më të ulëta e më të larta
- ← të ndërtojë marrëdhëniet të barabarta mes djemve e vajzave me qëllim forcimin e ndjenjës së kolektivitetit e mirësjelljes reciproke në veprimtari dhe mësim.
- ← të bashkëpunojë me psikologun ose punonjës social për nxënësit me aftësi të kufizuara, për nxënësit me vështirësi në të nxënë, për të sapoardhurit dhe nxënësit me shqetësime të sjelljes.
- ← të bashkëpunojë rregullisht me prindërit për mbarëvajtjen e shkollës nga nxënësit; për frekuentim sa më të rregullt.
- ← të informojë nxënësit dhe prindërit e tyre rreth: kurrikulës me zgjedhje (të detyruar dhe të lirë) që shkolla u ofron; rreth opsioneve të karrierës së nxënësit me përfundimin e gjimnazit .
- ← të bashkëpunojë me mësuesit lëndorë që nxënësit të mos mbingarkohen me përgatitje të shumta për provime.

Përgjegjësitë e Mësuesit kujdestar të klasës

a. Bashkëpunimi i Mësuesit kujdestar të klasës me nxënësit e klasës në kujdestari

Në librin “Pedagogjia”, Profesor Musa Kraja shkruan: “Komunikimi i mësuesit kujdestar me nxënësit është një çështje themelore, në të cilën ndërthuren koncepte, parime dhe norma kryesore të pedagogjisë. Mësuesi kujdestar dhe nxënësi janë dy bashkëpunëtorë të ngushtë gjatë gjithë viteve të shkollimit. Për të kryer detyrat e tyre, ata duhet të sigurojnë një bashkëpunim

të ngushtë, marrëdhënie të drejta mes tyre për të ndihmuar ndërsjelltasi njëri-tjetrin. Këto marrëdhënie i shohim në dy fronte kryesore. Në procesin mësimor, d.m.th., brenda orës së mësimi dhe në aspektet jashtë këtij procesi, që në të vërtetë janë vazhdim i tij, si dhe në veprimtaritë edukative. Është e vështirë ti ndash këto dy fronte të marrëdhënieve midis mësuesit kujdestar dhe nxënësve. Aq sa është e rëndësishme marrëdhënia në orën e mësimi po aq e rëndësishme është edhe marrëdhënia jashtë orës së mësimi” (Kraja, 2012: 244).

Sipas nenit 86 të Dispozitave Normative të arsimit parauniversitar mësuesi kujdestar është i detyruar të njohë secilin nxënës, me prirjet që ka secili prej tyre për pjesëmarrje në olimpiada apo gara të ndryshme.

Po ashtu në fund të vitit shkollor mësuesi kujdestar shpall tre nxënësit e klasës me mesatare më të lartë vjetore. Mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës u japin këtyre nxënësve certifikatën “Më të mirët e vitit në mësim” (në klasën ...në shkollë). Ky vlerësim shënohet në dëftesën e klasës.

Mësuesi kujdestar ndërmjetëson në zgjidhjen e problemeve të përditshme mes dy nxënësve ose dy grupe nxënësish, ose me anë të impaktit të tij, ose me anë të masave disiplinore të sqaruara në nenin 108 “Veprimet e përshkallëzuara për shkeljet e nxënësit”.

Sjelljet problematike të nxënësve mund të shkaktohen nga shumë faktorë. Mësuesi kujdestar duhet të përcaktojë mirë se çfarë e shkakton sjelljen. Ky është hapi i parë për të parandaluar sjelljet problematike. Disa nga faktorët e këtyre sjelljeve janë: mjedisi familjar, grupet e moshatarëve, pasionet shoqërore dhe faktorë të tjerë brenda dhe jashtë shkollës” (Karaj, 2008: 2)

Masat disiplinore ndaj nxënësve, përgjithësisht, paraprihen me veprime të përshkallëzuara nga mësuesi kujdestar dhe komisioni i disiplinës, duke pasur parasysh udhëzimet e mëposhtme:

- ← Mësuesi lëndor e këshillon nxënësin individualisht.
- ← Mësuesi kujdestar kërkon takim me të paktën njërin prind të nxënësit, në prani të nxënësit.
- ← Mësuesi kujdestar kërkon ndihmën e psikologut ose punonjësit social për të shqyrtuar shkaqet e sjelljes së nxënësit.
- ← Mësuesi kujdestar kërkon mbledhjen e këshillit të prindërve të klasës në prani të nxënësit dhe prindit të tij.
- ← Me kërkesën e mësuesit kujdestar ose të drejtorit të shkollës, nxënësi i kërkon të falur atij ose atyre që janë prekur nga sjellja e tij (me gojë, me shkrim, në prani të mësuesit kujdestar, në prani të të gjithë mësuesve lëndorë, ose të drejtorit, ose të komisionit të disiplinës, vetëm ose bashkë me prindërit e tij).

Raste të rralla shkojnë deri në Këshillin e Disiplinës që sipas nenit 109, “Në mbledhjen e komisionit të disiplinës merr pjesë nxënësi (nxënësit), për të cilët shqyrtohet shkelja, mësuesi (mësuesit) kujdestar i nxënësve, psikologu e punonjësi social dhe të tjerë që ftohen nga komisioni; ftohen të marrin pjesë prindërit e nxënësit”.

Një nga problemet që shqetëson sot shkollën është numri i madh i mungesave që bëjnë nxënësit gjatë vitit shkollor. Sipas Dispozitave normative 2013, një nga detyrat e mësuesit kujdestar të klasës është dhënia leje dhe justifikimi i mungesave të nxënësve të klasës që ka në kujdestari.

Kjo detyrë rrit kompetencat e mësuesit i cili është në kontakt të drejtpërdrejt me nxënësin dhe e njej mirë atë. Sa më i mirë të jetë komunikimi mësues kujdestar – nxënës – prind, aq më i mirë është frekuentimi i nxënësve në shkollë duke mos lënë hapësira për abuzim.

Mungesat e nxënësit janë të arsyeshme kur justifikohen me raport mjekësor ose prindi ka kërkuar leje paraprakisht dhe më pas ka paraqitur një shënim sqarues. Prindi e paraqet arsyetimin për mungesat e fëmijë së tij te Mësuesi kujdestar. Arsyetimet me shkrim të prindit ruhen nga mësuesi kujdestar për 1 (një) vit shkollor.

Sipas nenit 89 të Dispozitave Normative, Mësuesi kujdestar ka të drejtë të vlerësojë si të arsyeshme/të paarsyeshme mungesa deri në dy ditë gjatë një muaji. Për mungesa më të gjata se dy ditë, vlerësimi bëhet me shkrim nga drejtori/nëndrejtori i shkollës dhe i dorëzohet Mësuesit kujdestar.

Brenda javës së parë të çdo muaji, mësuesi kujdestar i dorëzon drejtorit/nëndrejtorit të shkollës tabelën e mungesave mujore të klasës, të ndara në: gjithsej, të arsyeshme, të paarsyeshme, mungesa 1-3 orëshe.

Me lejen e mësuesit kujdestar ose stafit drejtues (pasi ka komunikuar me prindin nëpërmjet celularit të shkollës) nxënësi mund të largohet nga shkolla brenda orarit mësimor.

Kur një nxënës sëmuret ose pëson aksident,- sipas Nenit 116 të Dispozitave normative - mësuesi kujdestar ose një drejtues i institucionit arsimor njofton menjëherë prindin.

b. Bashkëpunimi i Mësuesit kujdestar të klasës me prindërit e klasës në kujdestari

Bashkëpunimi midis shkollës dhe familjes duhet të lidhet me ndjenjën e përgjegjësisë së ndërsjellët, në mënyrë që të sigurohet suksesi në zhvillim tërësor të fëmijës. Lidhja mësues kujdestar-prind duhet të bazohet në frymën e mirëbesimit që krijon një komunikim të efektshëm. Mësuesi kujdestar duhet t’i kthejë prindërit në konsulentë, për të kuptuar veçoritë individuale të gjithsecilit. Është e rëndësishme që mësuesi të dëgjojë dhe të mbajë mend të gjithë informacionet që përcjellin prindërit për fëmijët e tyre.

Sipas Nenit 84: Shkolla dhe Familja, janë dy institucione të rëndësishme dhe bashkërisht të interesuara drejtpërsëdrejti për mirëritje, edukim dhe arsimim. Komunikimi dhe bashkëpunimi shkollë/prind(familje), kur zhvillohet në mënyrë sistematike, dhe strukturohet në mënyrë profesionale kthehet në një faktor favorizues për suksesin e fëmijës/nxënësit, i cili në fakt është sukses jo vetëm i nxënësit, por edhe i shkollës dhe familjes.

“Mënyra si shkolla e sheh fëmijën reflektohen në mënyrën si shkolla e sheh familjen e nxënësit. Nëse mësuesit e shohin fëmijën thjesht si nxënës, ata janë duke e parë familjen të shkëputur nga shkolla. Nëse mësuesit e shohin nxënësin si fëmijë ata janë duke e konsideruar së bashku familjen dhe komunitetin si partnerë të shkollës në edukimin dhe zhvillimin e nxënësit” (Sadker Pollack Myra, Sadker Miller Davis, 1995:243).

Shkolla e vlerëson rëndësinë që ka prindi si mësues i parë dhe si njohës i fëmijës së tij. Prindërit konsiderohen partner të mësuesve gjatë procesit të arsimit edukimit të fëmijëve. Që në takimin e parë Mësuesi kujdestar i nje prindërit dhe nxënësit me:

- kushtet e shëndetit dhe të sigurisë në institucion;
- me nenet e Dispozitave Normative që shtjellojnë të drejtat dhe detyrimet e prindërve e të nxënësve dhe detyrimet e punonjësve të institucionit arsimor ndaj prindërve e nxënësve;
- me rregulloren e brendshme të institucionit;
- me kurrikulën me zgjedhje;
- me mundësitë e karrierës së fëmijës pas përfundimit të një niveli arsimor;
- me procedurat e zhdëmtimeve dhe procedurat e ankimit.

Për një bashkëpunim afatgjatë, Mësuesi kujdestar i nje prindërit me planin e punës edukative që ka hartuar me nxënësit, në mënyrë, që të tërheqë mendimet dhe vërejtjet e tyre, dhe, mbi të gjitha, të sigurojë edhe ndihmën e prindërve në zbatimin praktik të tij.

Këshilli i prindërve të klasës, që zgjidhet që në takimin e parë, është një mbështetje aktive e Mësuesit kujdestar në organizimin dhe bashkëpunimin me prindërit e klasës për problemet e edukimit e arsimit.

Mësuesi kujdestar fton në mbledhje të përgjithshme të gjithë prindërit, bashkë me nxënësit ose pa ta, të paktën një herë në tre muaj, ku parashtron çështje që i takojnë klasës në tërësi; shtjellon tema rreth rolit të prindërve në suksesin e fëmijëve të tyre. Mësuesi kujdestar e ka të ndaluar që në mbledhjet me prindërit të përmendë me emër nxënës të klasës për mosarritje ose arritje të tyre. Informacioni për nxënësin i jepet vetëm prindërve të tij.

Sipas Nenit 97 të Dispozitave Normative Mësuesi ndihmës ose Mësuesi kujdestar informon prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara (AK) për shërbimet shtetërore shëndetësore rehabilituese që u ofrohen këtyre fëmijëve. Afrimi dhe ndihma që u jep Mësuesi kujdestar fëmijëve me AK ka rëndësi të madhe për mbarëvajtjen dhe përparimin e tyre në shkollë.

c. Çfarë përgjegjësie ka Mësuesi kujdestar në lidhje me dokumentacionin shkollor?

Sipas Nenit 84 të Dispozitave Normative Mësuesi kujdestar ka për detyrë të plotësojë faqet e regjistrit të klasës. Në fund të çdo dite ai hedh në fletën përkatëse të regjistrit mungesat dhe në fund të javës dhe të muajit i paraqet me shkrim nëndrejtorit përkatës, duke vazhduar me këtë rregull deri në fund të vitit shkollor. Regjistri plotësohet, sipas rregullave në fuqi, vetëm nga mësuesit lëndorë të klasës dhe mësuesi kujdestar i klasës. Në periudhën kur regjistri nuk përdoret në klasë, mund të merret vetëm nga mësuesi kujdestar i asaj klase, mësuesit lëndorë të asaj klase, inspektorët, që janë duke kryer inspektim në shkollë, të tjerë që janë të autorizuar me shkrim nga drejtori i shkollës.

Edhe orët e kujdestarisë shënohen nga mësuesi kujdestar në një faqe të posaçme të regjistrit të klasës. Ndërsa ditari i orëve të kujdestarisë është objekt inspektimi nga ISHA.

Mësuesi kujdestar përgatit për çdo nxënës edhe dëftesën e fund vitit dhe ia dorëzon prindit të tij.

Në rastet e veprimtarive jashtëshkollore, sipas Nenit 102 Drejtori i institucionit arsimor ose mësuesi kujdestar njoftojnë prindin dhe kërkojnë lejen e tij me shkrim për veprimtari të nxënësit pas orarit mësimor ose veprimtari jashtëshkollore.

Sipas Neni 119, Mësuesi kujdestar e ka detyrim t'i njohë dhe t'i këshillojë nxënësit për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e inventarit dhe mjediseve shkollore. Për dëmtimin/vjedhjen e pronës publike në institucionin arsimor nga nxënësit, Drejtori/nëndrejtori, harton proces-verbalin, ku përshkruan ngjarjen dhe dëmin. Mësuesi kujdestar njofton prindërit e nxënësit.

Në arsimin fillor, karakteristikat e nxënësit hartohen nga mësuesi i tij. Përtej arsimit fillor, mësuesi kujdestar këshillohet me mësuesit e tjerë të nxënësit. Në gjimnaz mësuesi kujdestar mban shënim për çdo nxënës numrin e krediteve që ka fituar në çdo vit shkollor, sipas një formati të gatshëm.

Në Nenin 110 përcaktohet se në rast të moszbatimit të Dispozitave Normative, merren këto masa: Komisioni i disiplinës i institucionit arsimor vendos masën disiplinore për mësuesin, kur konstaton shkelje të legjislacionit në fuqi, ose të Dispozitave Normative, të rregullores së brendshme të institucionit; shkelje të etikës e të sjelljes në institucion; mosarritje të nxënësve, të përcaktuara në mënyrë objektive, si: testimet e drejtorisë së institucionit ose të njësisë arsimore vendore, rezultatet në provimet kombëtare, vlerësimi i ISHA.

Masat e përshkallëzuara që komisioni i disiplinës vendos për mësuesin ose nëndrejtorin, janë: Qortim; Vërejtje; Paralajmërim për largim nga puna. Masa është e shlyer kur një periudhë gjashtëmujore komisioni i disiplinës nuk ka shqyrtuar shkelje tjetër të mësuesit/nëndrejtorit.

Intervista të drejtpërdrejta me drejtues shkollash dhe mësues kujdestarë të shkollave 9-vjeçare dhe gjimnaze.

Gjetjet kryesore të realizuara gjatë intervistave të drejtpërdrejta dhe të thelluara me drejtues shkollash dhe mësuesi kujdestarë të disa shkollave 9-vjeçare dhe gjimnaze tregojnë se puna e Mësuesit kujdestar nëpër shkolla, roli, misioni, funksioni dhe përgjegjësia, mbështeten në një vlerësimin tradicional më tepër sesa në njohjen apo interpretimin e bazës ligjore

ekzistuese. Mësuesi kujdestar i klasës është një menaxhues i mirë i klasës, është koordinatori që lidh klasën me drejtorinë e shkollës e me mësuesit lëndor të klasës, është koordinator që lidh shkollën me familjen.

Përgjigjet e të intervistuarve bazohen në njohjen e Rregullores së shkollës ku pasqyrohet më shumë neni 84 dhe më pak Nenet 86, 89, 108, 112, shtojca 9 në Dispozitat Normative 2013.

Në lidhje me pyetjen: “Ç’ bën konkretisht Mësuesi kujdestar i klasës sot?”

Përgjigjet e të intervistuarve tregojnë se mësuesi kujdestar sot kontrollon çdo ditë paraqitjen e nxënësve në shkollë në orarin e caktuar. Kujdeset për hyrjen e nxënësve të kujdestarisë në shkollë e klasë, për qëndrimin e tyre në shkollë e klasë sipas orarit mësimor, për respektimin e rregullit gjatë pushimeve mes orëve të mësimi. Përgjigjet për marrëdhëniet e nxënësve me mësuesit e lëndëve që japin mësim, ose me mësuesit zëvendësues. Kujdeset për marrëdhëniet e nxënësve me njëri-tjetrin brenda klasës, marrëdhëniet me nxënësit e tjerë të klasave paralele, më nxënësit e klasave më të ulëta e më të larta. Plotëson çdo ditë regjistrin, kontrollon mirëmbajtja e klasës me bazën materiale të saj.

Sipas të intervistuarve kjo është puna rutinë e përditshme e mësuesit kujdestar, e cila pasohet me të tjera përgjegjësi brenda javës apo muajit si: realizimin e orës edukative sipas planit vjetor, zgjidhja e ndonjë problemi moshor ose institucional, monitorimi i rezultateve mësimore të të gjithë nxënësve, shoqërimi në veprimtaritë pas mësimi, përgatitja për takimin me prindërit dhe gatishmëria për t’u përgjigjur edhe në rast se takohet jashtë mjedisit të shkollës me prindër që nuk vijnë në takimin e planifikuar etj.

Në lidhje me pyetjen: “Sa vlerësohet dhe si çmohet kjo punë?”

Të intervistuarit janë të mendimit se këtu ka vend për të diskutuar e për t’u parë.

Kjo çështje lidhet me pyetjen tonë kërkimore: A do të zgjidhen të gjitha këto përgjegjësi që i atribuon kuadri ekzistues ligjor ekzistues rolit të Mësuesit kujdestar nëpërmjet ridimensionim të rolit të tij, apo roli i tij me kalimin e kohës do të zëvendësohet me hallka të tjera të edukimit?

Mbështetur në trajtimin teorik, në modele jashtë Shqipërisë dhe në perceptimin dhe rekomandimet e të intervistuarve, unë mendoj se në kushtet e vendit tonë, më e përshtatshme shtrohet nevoja e ridimensionimit të rolit të mësuesit kujdestar, duhet të trajtohet parë në tre kuptime:

- ← në përgjigje të nevojave të sistemit aktual arsimor shqiptar (në qendër të të cilit vendoset nxënësi),
- në identifikimin e modeleve më të përparuara perëndimore të rolit, përgatitjes dhe profilit të mësuesit kujdestar,
- ← në identifikimin e modelit më të përshtatshëm në funksion të shkollës shqiptare sot pa anashkaluar edhe përvojën apo praktikën e përditshme dhe traditën pozitive shqiptare.

Ridimensionimi i rolit të mësuesit kujdestar lidhet dhe me edukimin global. Edukimi globalist sot është një nevojë jetike, një mjet për të përballuar jetën kudo që të hedhë ajo.

Në librin “Mësimdhënia me në qendër nxënësin” thuhet:

“Qëllimet e përgjithshme të arsimit tonë të shpallura në dokumentet zyrtare kombëtare nënvizojnë se arsimit ynë do të synojë të përgatisë nxënësit të aftë të jetojnë e të përballojnë këtë botë globale gjithnjë në rritje dhe të jenë qytetarë pjesëmarrës efektivë, që kontribuojnë për një të ardhme më të mirë”. Dhe më poshtë vijon citimi: “Edukimi global nxit mësuesit dhe nxënësit të bëjnë një shikim të gjerë të problemeve dhe të çështjeve:

- ← Ta shohin veten si qytetarë globalë me të gjitha përgjegjësitë që shoqërojnë këtë pozicion dhe po ashtu, ta shohin veten si pjesëtarë të komunitetit apo të vendit përkatës.
- ← Të kuptojnë problemet kyçe që e shoqërojnë botën sot- dhunimi mjedisor, varfëria, mohimi i të drejtave etj. dhe të luajnë pjesën e tyre në gjetjen e zgjidhjeve krijuese.
- ← Të mendojnë në mënyrë konstruktive për të ardhmen dhe për rolin e tyre për modelimin e saj si dhe të nxënë nga e kaluara”(Grup autorësh, 2008:92).

Bibliografia

- Sadker Pollack Myra, Sadker Miller Davis, (1995) Mësuesit, shkollat, shoqëria, botim i ISP, Eureka, Tiranë
- Tamo. Adem, (1999) Edukimi i qytetarisë demokratike në shkollën fillore, botim Pegi,
- Backman, E., & Trafford, B (2007). Democratic Governance of Schools, Botim i Këshillit të Evropës F-67075 Strasbourg Cedex <http://book.coe.int>.
- Dibra, Gëzim & Taipi, Mirjam & Halluni Eranda. (2013). Mësuesi dhe mësimdhënia, botime “Vllamasi”.
- Epstein, J. L., Sanders, M. G., Simon, B. S., Salinas, K. C., Jansorn, N. J., & Van Voorhis, F. L. (2002). School, family and community partnerships,
- Frabboni, Franco. & Minerva, Pinto, Franca. (2003) “Manual i Pedagogjisë së Përgjithshme” botim i ISP, Grup autorësh, (2008), “Mësimdhënia me në qendër nxënësin”, Tiranë
- Kraja, M., (2012) Pedagogjia, botim Erik,
- Karaj, Th., (2008) Menaxhimi i klasës, botim Emal,
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Dispozitat normative, Për Sistemin Arsimor Parauniversitar, Tiranë, 2013, (<http://www.vet.al/files/ligje%20etj/Dispozitat%20normative%202013.pdf>).
- Voronin, Y., (9 janar 2015), (<http://paidagogos.com/?p=7836#>)

DIMENSIONET E TEORIVE ARSIMORE DHE VLERAT NË PROCESIN MËSIMOR EDUKATIV

PROF. ASOC. DR. BASHKIM PEÇI

Pedagog i jashtëm, Fakulteti i Shkencave Sociale, Departamenti i

Edukimit b.peci@yahoo.com

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij studimi është identifikimi i dimensioneve dhe vlerave që teoritë arsimore kanë për procesin mësimor edukativ, duke evidentuar përjasjen e sistemit arsimor shqiptar me atë progresist bashkëkohor. Teoritë arsimore janë sinteza teorike metodologjike të përvojave pedagogjike botërore, mbi konceptet e të cilave sendërtohet procesi mësimor edukativ, në përmbajtje dhe metodologji. Të konkretizuara në modele arsimore, realizohet mësimdhënia dhe të nxënësve efikas edhe në kushtet aktuale të arsimit tonë. Teoritë arsimore janë një risi e konceptimeve liberale demokratike dhe shkencore të shekullit XX, por ide e koncepte pedagogjike, të bazuara në filozofinë dhe pedagogjinë popullore, në mendimet e filozofëve dhe reformatorëve të arsimit janë hedhur në etapa të ndryshme të zhvillimit historik. Zhvillimet demokratike të viteve '90 thyen kornizën e konceptimit të ngurtë një partiak, duke krijuar hapësira për shpërfaqjen e shumësisë së ideve dhe të koncepteve, sipas filozofive dhe teorive arsimore, çka i ishte privuar shkollës tonë. Pluralizmi i ideve arsimore e nxori arsimin nga konceptimet moniste tradicionale dhe krijoi hapësira për të qenë pjesë integrale e sistemit arsimor botëror. Teoritë arsimore klasifikohen në të përgjithshme dhe që trajtojnë koncepte specifike; në objektive dhe subjektive, etj. Mbi bazën e avantazheve të teorive arsimore, bëhet përzgjedhja e elementeve të tyre, për formësimin e qasjeve të kombinuara, duke ofruar kështu pozicione të ndryshme për trajtimin e problematikës, sipas cikleve të shkollimit. Trajtimi holistik i begraundit historik, filozofik, psikologjik, social, human, pluralist i jep teorive arsimore dimensionet e nevojshme për evoluimin e mendimit kritik dhe krijues të nxënësve dhe studentëve, sipas qasjes me nxënësin në qendër. Gjithnjë e më shumë kjo metodë po orientohet nga teoria konstruktiviste, që mundëson zhvillimin në mënyrë efektive të kompetencës profesionale dhe qytetare për të qenë sfidat në drejtimin që zgjedhin.

Fjalë kyç: *dimensionet e teorive arsimore, aspektet sociale (historike, filozofike, psikologjike, sociale, humane, pluraliste), konceptimi monist tradicional dhe kuptimi holistik arsimor, shumëllojshmëria teorike dhe modelet arsimore.*

Hyrje

Për teoritë dhe teoritë arsimore janë dhënë shumë përcaktime. Sipas Kerlinger, teoria përfaqëson “Një set konceptesh të ndërvarura, që paraqet një pamje sistematike të fenomenit me marrëdhënie të veçanta midis variabileve, që ka si qëllim shpjegimin e dukurive.” (1973: f. 9) Ndërsa Knud, nga perspektiva psikologjike mendon se teoritë arsimore janë korniza konceptuale, që përshkruajnë se si informacioni absorbohet, përpunohet dhe tërhiqet gjatë të mësuarit. (2004). Objekt i këtij shkrimi janë dimensionet e teorive arsimore, përmbajtja dhe reflektimi në problematikën mësimore edukative.

Teoritë arsimore janë risi e shekullit të XX, por arsimit dhe mendimi pedagogjik është zhvilluar edhe kur ato nuk ishin formuluar si të tilla. Teoritë e edukimit janë përvijim i filozofisë dhe pedagogjisë popullore dhe i ideve të mendimtarëve të shquar nëpër kohëra. Ato kanë një lidhje të ngushtë me filozofit e edukimit sa që shpesh, përdoren në vend të njëra tjetrës. Dimensionet e filozofisë kanë mundësuar sendërtimin e shumë disiplinave të shkencave sociale, përfshi këtu edhe teoritë arsimore, që zhvillohen në fushën e pedagogjisë.

Me fillimin e shekullit të 20-të nisi të fryjë një erë e re në mendimin filozofik: u shfaqën rryma e shkolla të mendimit filozofik, u përvijuan filozofi të reja progresiste, si ekzistencializmi dhe pragmatizmi, të cilat sollën risi në trajtimin e shkollës. Në atë kohë u zhvilluan shumë teori arsimore, si: Teoria e B.F. Skinner apo teoria e stimul-reagimit, që bazohet në përsëritjen shumë herë të një veprimi; Teoritë e kushtëzimit klasik të Pavlovit, të bazuar në reflektet e kushtëzuara dhe pakushtëzuara; Ligjet e të mësuarit dhe teoria e provës dhe gabimit, sipas E. L. Thorndike; Kushtëzimi operant i B. F. Skinnerit, mbi efektin e reagimit në të mësuarit; ide të Vigotskit mbi atë që duhet synojë të arrijë nxënësi, sipas konceptit të Zonës së Zhvillimit të Përafërt, apo koncepti se të tjerët luajnë rolin e një skele në lartësimin e dijes së një fëmije; Xhon Djui mbi pragmatizmin dhe parimet demokratike në arsim; J. Bruner, të mësuarit për të zbuluar gjëra të reja, mbi bazën e atyre që di; Teoria konstruktiviste e skemave mendore dhe sendërtimit të mendimit e Piazhës; Teoria e vëzhgimit social dhe e modelimit të Bandurës; Teoria e Friend, mbi dijet që sendërtohen në ndërveprimin social me të tjerët dhe interpretohen përmes filtrave kulturor; Teoria Gestaltiste (e formës), fokusimi tek kuptimi holistik, jo thjesht tek pjesët e shkëputura, duke shënjuar zhvendosjen drejt të mësuarit konjitivist; Teoria e hierarkisë së motivimit të Maslout dhe e motivimit sipas Keller; Teoria e kushteve, kategorive, dhe strategjive të mësimit të R. Ganjes; Teoria e Kolbit mbi të mësuarit eksperimental; Teoria e inteligjencës së shumëfishtë të H. Gardner, pikasja e preferencave të fëmijëve nga prindërit, mësuesit dhe zhvillimi i tyre; mbi inteligjencën emocionale të Goleman, etj.

Në rrafshin pedagogjik teoritë u diferencuan sipas objektit dhe funksionit të tyre në: Teori të mësimdhënies (teaching) dhe të nxënies (learning); Teoritë që vijnë nga fusha e filozofisë, psikologjisë, teori humane; me profil më të gjerë (teoritë biheviore, konjitiviste, konstruktiviste) apo më të ngushtë, që fokusohen në aspekte të veçanta të të mësuarit; etj.

Në funksion të shkollës (kurikulës, mësimdhënies, të nxënies) ka shumë teori arsimore, por në literaturën pedagogjike pranohet gjerësisht se tre janë teoritë arsimore bazë: biheviore, konjitivizmi dhe konstruktivizmi.

Biheviore, mori trajtë sipas konceptimit të Watson, ku të mësuarit mendohej si përvetësimi i një sjellje të re. Kjo, si përmes kushtëzimit klasik, ku sjellja shihet si reagim ndaj një stimuli të kushtëzuar, apo, sipas konceptit të Kushtëzimit operant, ku sjellja përforcohet nga lavdërimi (që rrit gjasat për sjellje të mirë) apo qortimi e dënimi, që mund ti dobësojë gjasat nëse nuk përdoren me efikasitet. Gjithashtu, biheviore theksuan rolin që ka përpunimi i mjedisit në përfitimin e reagimeve të dëshiruara. Sipas kësaj qasje edhe të menduarit realizohet nëpërmjet kushtëzimit. Mbi këto koncepte, në fushën arsimore, përcaktohen objektivat e sjelljes, që janë të matshme, promovohet të mësuarit i bazuar në kompetenca, dhe kryhet zhvillimi i aftësive dhe trajnimi i subjekteve përkatëse.

Konjitivizmi, si teori arsimore, nisi me konceptet Gestaltiste, që u zhvendosën përtej konceptimit të njëanshëm stimul – reagim, duke u fokusuar tek kuptimi holistik, i perceptimit të dukurisë, duke e orientuar njohjen drejt kuptimit konjitivist. Çfarë mundësonte shqyrtimin konjitiv e metakonjitiv të procesit njohës, të perceptimit, ruajtjen e informacionit në kujtesë dhe përpunimin e tërheqjen e tij, kur ishte e nevojshme. Në këtë linjë arsyetimi u përpunua teoria konjitiviste, çka përbën një zhvillim të mëtejshëm në konceptimin mbi të mësuarit. Sipas linjës konjitiviste u modeluan konceptime të reja mbi arsyetimin, inteligjencën, përkufizimet, klasifikimet, zhvillimin e planifikuar të mësimit, koncepti i skemave dhe hartave mendore në zhvillimin konjitiv, duke mbajtur parasysh veçoritë e rritjes së fëmijës, aspektet individuale, sociale, humane, etj.

Konstruktivizmi është teoria sipas së cilës njerëzit gjenerojnë kuptime dhe dije nga ndërveprimi i përvojave me idetë e përfituara rishtas, duke reflektuar në situatën e dhënë. Të mësuarit konstruktiv mbështetet në idetë e Djuit, Marie Montesorit, Piazhës, Vigotskit, David Kolbit, etj. Konstruktivizmi ka dy degëzime (konjitiv dhe social-kulturor), dhe zhvillohet në disa kuptime, sikurse janë: të mësuarit aktiv, të mësuarit me zbulim, dhe sendërtimi i njohurive. Në të gjitha aspektet nxënësi nxitet për të eksploruar në mënyrë të çlirët, brenda një kuadri apo strukture të caktuar.² Kurikula bazohet në atë çka nxënësi di dhe është në gjendje të bëjë, jo në tutelën e mësuesit. Mësuesi, del nga monotonia, në rolin e ekspertit mendon për pikat e forta dhe dobësitë e nxënësit, vepron si lehtësues (por jo thjeshtë), duke e ndjekur me intuitë, ndërsa nxënësi përpunon të motivohet, të vetë mësojë, duke zbuluar fakte / koncepte të reja. Carlile dhe Jordan vënë në dukje se “mësuesi nuk është thjeshtë një “lehtësues i të mësuarit”, ai bën më shumë, vepron si një drejtues orkestre, që njih si natyrën e muzikës edhe stilet dhe aftësitë e interpretuesit” (2009: f. 8).

Për të pasur një orientim më të drejtë është bërë edhe klasifikimi në teori objektivist dhe subjektivist. Në grupimin e parë renditen edhe teoritë biheviore dhe konjitiviste, pasi ato vijnë nga fusha e psikologjisë dhe bazohen në të dhëna shkencore

← Natyrisht që nuk është vendi për të përshkruar gjerësisht, por për të thënë se seicila ka një objekt të veçantë dhe mund të gjejë zbatime konkrete në shkollë. Emrat e kontribuesve në mendimin teorik janë shkruar sikurse shqiptohen.

← Devries, B.; Zan, B. (2003). “When children make rules”. Educational Leadership 61(1): 64–7.

(empirike), ndërsa në grupimin e dytë bëjnë pjesë teoritë subjektivistë, konstruktivistë, interpretivistë (kërkuesi si faktor social normative (si duhet të jetë dukuria), që vijnë nga fusha e filozofisë, bazuar në efëncën e intuitës, interpretimit dhe hamendësimit filozofik. Teoritë objektivistë krijojnë një lloj pasiviteti tek nxënësi, pasi ai duhet të ndjek ato që janë shkruar në libra dhe i thotë mësuesi. Ato bazohen në planifikimin e orës mësimore, me rregull të fortë dhe zbatimin e sekuencave përkatëse. Nëse mësuesi ka koncepte të qarta dhe vepron drejtë atëherë edhe nxënësi do të mësojnë mirë. Ndërsa qasjet subjektivistë fokusohet tek roli i individit (nxënësit), aftësitë për të sendërtuar kuptime të reja mbi bazën e përvojës. Mësimi në konceptin konstruktivist del nga klišetë dhe të mësuarit vlerësohet i suksesshëm kur nxënësi demonstroi atë që ka mësuar vetë.

Rëndësia e filozofive dhe teorive arsimore evidentohet qartë edhe nga praktikatat që ndiqen në vendet e zhvilluara për përbajtjen dhe përzgjedhjen e shkollës. Aktualisht vendet e zhvilluara me standarde të larta e bazojnë arsimin në filozofitë dhe teoritë arsimore. Mjafton të shkruash në Google: What is your philosophy of education? dhe shfaqet testi që përcakton se nga cila filozofi arsimore priret i interesuari. Mbi këtë bazë mësuesit, nxënësit, prindërit, drejtuesit e shkollës zgjedhin shkollën përkatëse, sepse nga filozofitë dhe teoritë arsimore se ndërtohen kurrikulat, rekrutohet stafi mësimor dhe drejtues. Mbi këta tregues, nxënësit dhe prindërit përzgjedhin shkollën.

Në materialin e BE mbi trajnimet për përmirësimin e cilësisë në shkencën e mësimdhënies evidentohet se: “Në vitet e fundit konstruktivizmi, si një qasje në arsim, ka një pozicion qendror në literaturën didaktike. Numri i artikujve shkencorë dhe librave mbi konstruktivimin si teori dhe si një qasje në arsim është i madh. Ai po përdoret në zhvillimin e standardeve të arsimit në një numër të shteteve në SHBA dhe përdorimi i tij në mësimdhënie rekomandohet gjithnjë e shumë në disa vende të BE. Teoria konstruktivistë pa diskutim pranohet si një teori moderne dhe kryesore në mësimin e shkencës”.³ Dhe më tej, “Konstruktivizmi përmban parimet më të vlefshme për udhëzimin e mësimin shkencor, si dhe për studiuesit në këtë fushë”.⁴

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Synimi i studimit është evidentimi i principeve dhe vlerave të teorive arsimore për sendërtimin dhe funksionimin e procesit mësimor, rëndësinë që ato kanë në krijimin e modeleve, strategjive, teknikave të mësimdhënies dhe të nxënies. Mbi bazën e gjetjeve të sugjerohen ide dhe praktika mbi zhvillimin efikas të procesit mësimor edukativ nga perspektivat e teorive arsimore. Kjo edhe për faktin se vitet e fundit teoritë arsimore përbëjnë një temë, që ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve dhe institucioneve që kanë në fokus zhvillimin e arsimit mbi bazën e qasjeve bashkëkohore.

Objektivat e studimit

- ← Të evidentohen dimensionet dhe vlerat e teorive arsimore dhe pasqyrimi në procesin mësimor edukativ
- ← Të përshkruhen veçoritë dhe koherenca midis filozofive, teorive, modeleve dhe metodologjive arsimore
- ← Të përshkruhet rëndësia që kanë teoritë arsimore në përpunimin e strategjive dhe teknikave të mësimdhënies dhe nxënies
- ← Nisur nga konceptimet teorike arsimore mësuesit, nxënësit, specialistët, punonjësit arsimor të trajtojnë në mënyrë efikase problematikën pedagogjike
- ← Të bëhen sugjerime mbi perspektivën e teorive arsimore në procesin mësimor edukativ

Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Pyetja kryesore: Sa evidentohen vlerat e teorive arsimore në procesin mësimor edukativ?

Studimi dizajnohet për të vlerësuar hipotezën se zbatimi efikas i teorive arsimore në shkollë do të rriste performancën e mësuesve dhe nxënësve. Duke u nisur nga perceptimi se teoritë arsimore nuk reflektohen sa dhe si duhet në praktikën mësimore edukative bëhen përpjekje për evidentimin e korrelacionit si më poshtë:

Hipoteza: Zbatimi efikas i teorive arsimore në shkollë rrit nivelin akademik në kurikul, mësimdhënie dhe nxënie dhe performancën qytetare të nxënësve.

Metodologjia e punimit

Për realizimin e studimit u përdor qasja e kërkimit cilësor, si metodë efikase për të siguruar informacion mbi impaktin që kanë filozofitë dhe teoritë arsimore në procesin mësimor. Projektimi i teorive në aspektet psikologjike, sociale, filozofike, humane, në nivelin akademik të nxënësve, në rrafshin e kuptimeve, besimeve, mendimeve, emocioneve, inteligjencës emocionale, zhvillimin

³ Improving Quality of Science Teacher Training in European Cooperation, <http://www.iqst.upol.cz/e-learning/m4/e-learning-m4-u2.php#top>

⁴ Duit, R. The constructivist view in science education – what it has to offer and what should not be expected from it, <http://www.if.ufrgs.br/public/ensino/N1/3artigo.htm>

⁵ Në literaturën pedagogjike konceptet qasje dhe metoda shpesh përdoren me kuptim të ndërsjellë. Por, qasja përmban një konceptim më të gjerë se sa metodat apo teknikat. Qasja i referohet parimeve, teorive, ndërsa metoda kupton realizimin praktik të qasjeve teorike, për arrijtjen e objektiveve të mësimdhënies dhe nxënies, nëpërmjet teknikave dhe procedurave konkrete.

e marrëdhëniet që përcaktojnë sjelljet, kompetencën dhe performancën e tyre. Duke qenë se dukuritë pedagogjike zhvillohen në kuadrin e normave shoqërore nuk mund të trajtohen pa rolin objektiv të hulumtuesit, që orienton problematikën e kërkimit dhe për hir të objektivitetit ka rolin e lehtësuesit neutral.

Më konkretisht, puna u fokusua në grupe me mësues dhe nxënës, si një metodë efikase komunikimi e qasjes së kërkimit cilësor, për të shkëmbyer njohuri, ide opinione, në përmbushje të qëllimit të takimit. U formuan katër fokus grupe me 7- 8 mësues nga shkolla të Tiranës, me vendndodhje nga zona të ndryshme. Në përbërje kishte mësues të arsimit të detyruar dhe të mesëm (N = 31). Në to, u diskutua rreth dy orë mbi përvojën mbi problematikën e teorive arsimore. U adresuan pyetje mbi kuptimin e qasjeve teorike, klasifikimin, konceptet, idetë, zbatimin e tyre në kurrikul, efikasitetin në mësimdhënie dhe nxënie, në kompetencën dhe performancën akademike dhe qytetare. Afërsisht të njëjtat kritere u përdorën edhe me fokus grupet e nxënësve. Në rastin e nxënësve u ruajt raporti meshkuj/femra, ndërsa në grupet me mësuesit predominonin mësueset, kjo sepse edhe raporti në shkollë është i tillë. Të dhënat u mbledhën në periudhën janar-mars 2015.⁶ U bë kujdes që mësuesit dhe nxënësit të sillnin përvoja nga klasa të ndryshme. U promovua mendimi kritik, duke i nxitur për arsyetime të qarta dhe të drejta, në funksion të çështjes në diskutim.

Po ashtu, u përdorën metoda të vëzhgimit në disa orë mësimore, me mësuesit e këtyre shkollave, për të parë konceptimin teorik dhe zbatimet konkrete në procesin mësimor edukativ. Në aspektin metakonjitiv, për të vjelë informacion më të detajuar, mbi kuptimet dhe interpretimet e tyre mbi teorinë arsimore, u përdorën intervista gjysmë të strukturuar (ballë për ballë dhe me telefon), me pyetje të paramenduara. Duke ju përmbajtur qasjes së kërkimit cilësor, ku hulumtuesi është pjesë e studimit, duke synuar për të kërkuar qartësi dhe thellësi në mendimin e të intervistuarit. Përpos kësaj, u organizuan tryeza me student të mësuesisë, mësues, që ndjekin studimet në nivelin master, nga ata që janë dhe nuk janë aktualisht në punë, nga qarqe të ndryshme të vendit.

Analizë, interpretim të dhënash

Nxënësi në qendër të procesit mësimor

Përpara se të bëhet interpretimi i të dhënave, duhet thënë se çështja e teorive arsimore është disi problematike edhe në botë. Në literaturën dhe praktikën pedagogjike ka dy tre shekuj që lançohet gjerësisht togfjalëshi: nxënësi në qendër të procesit mësimor⁷, por sa reale është kjo?

Qasja me nxënësin në qendër fokusohet në nevojat, interesat dhe aftësitë e nxënësit. Por, sa të aftë janë nxënësit të vetëmotivohen: në përzgjedhjen e arsimit të tyre, sipas standardeve të përmbajtjes dhe të arritjes; të orientohen në të mësuarit e kuptimshëm, aktiv konstruktiv, kundrejt të mësimi pasiv; si mund të veprojnë për të realizuar synimet e kësaj metode; si mund të kultivojnë mënyrën më efikase për të zgjidhur efektin e prishmërisë dhe varësisë së tyre nga mësuesi?, etj.

J. Bruner, që në vitet '60 shprehte rezerva për realizimin e qasjes me qendër nxënësin, jo vetëm në sistemin parauniversitar, por edhe në shkollën e lartë. Lidhur me këtë problem ai ka shtruar pyetjen se: A mund të inkurajohen nxënësit që të kenë pjesëmarrje aktive kur rreth 2/3 e bisedës në klasë bëhet nga mësuesi, dhe në 2/3 e asaj që trajtohet në klasë përqendrohet rreth çka thënë mësuesi?

Të tjerë studiues evidentojnë se pavarësisht përdorimit të gjerë të termit, të mësuarit me qendër nxënësit, në fakt nuk ndodh kështu. Lea et al. (2003) vë në dukje se “shumë institucione apo edukatorë pretendojnë se zbatojnë qasjen me nxënësin në qendër, por realisht ata nuk janë duke e bërë” (2003: 322). Kjo sepse zbatimi i kësaj qasje kërkon të mësuarit e thellë e të kuptimshëm; aktiv e jo pasiv, rrit përgjegjësinë dhe llogaridhënie nga ana e nxënësit.

Por, le ti referohemi gjendjes në arsimin shqiptar. Në analizën e rezultateve të PVNN-së 2000-2012, mbi arritjet e nxënësve në lexim, matematikë dhe shkencë, rezulton se “Pavarësisht tendencës në rritje, performanca e përgjithshme e Shqipërisë mbetet e ulët. Sipas PVNN, 2012 rezultatet e Shqipërisë janë më të ulëta në gjithë Evropën dhe Azinë Qendrore (EAQ) dhe ndër më të ulëta nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse në PVNN. Në përgjithësi, Shqipëria është rreth një vit shkollor mbrapa vendeve si Bullgaria, Rumania dhe Serbia dhe rreth dy vjet e gjysmë shkollorë (rreth 1 Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (në anglisht PISA (Programme for International Student Assessment) vii 100 pikë PVNN) pas mesatares së OBZHE-së. ... analiza tregon se të rinjtë që në të ardhmen e afërt do të hyjnë në tregun e punës mund të mos i kenë aftësitë e duhura për të plotësuar kërkesat e një ekonomie moderne e cila bazohet tek njohuritë”. (2014: 6-7)

← Studimi bazohet gjithashtu në përvojën shumëvjeçare të autorit mbi këtë problematikë në disa drejtime: Puna në Institutin e Studimeve Pedagogjike, si specialist për përgatitjen e programeve të lëndëve humane, ku duhej trajtuar me kompetencë profesionale përfshirja e teorive në kurrikul, duke mbajtur kontakte me mësuesit e këtyre lëndëve; trajtimi në këtë institucion i filozofive dhe teorive arsimore në kursin e drejtorëve të shkollave; përvoja pedagogjike në disa universitete, ku teorinë arsimore zënë një vend të rëndësishëm në kurrikulat e arsimit të lartë, konkretisht në lëndët: filozofit, teorinë dhe modelet arsimore, në disiplinat e kryqëzuara, si filozofi edukimi, sociologji edukimi, psikologji edukimi, etj.; nga vrojtimit e rastit dhe diskutimet me studentët në auditor mbi sendërtimin e kuptuarit dhe të bërit, nga pozitat e qasjeve subjektivist, konstruktivist, krahasuar me të mësuarit që përfitohet nga qasjet objektiviste; nga veprimtaria mësimore në Universitetin Evropian të Tiranës për trajnimin e drejtorëve të shkollës, ku një modul nga tre syresh trajton problematikën e teorive arsimore.

← Thekson rëndësinë e angazhimit aktiv të nxënësit në aspektin personal dhe ndërveprimin social për formësimin e dijes është trajtuar nga Pestaloci, Rusoi, Piazeha, Bruner, Vigotski, etj.

← Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve

Nga vlerësimi i sipërcituar dalin detyra për të gjithë subjektet që veprojnë në shkollë, për të gjetur mënyra efektive për përmirësimin me ritme të shpejta të gjendjes. Ashtu sikurse argumentohet edhe në këtë studim, arsimiti përbën një fushë komplekse, ku një vend qendror zënë dijet e bazuara në koncepte të qëndrueshme.

Çështjet në diskutimin e tryezave

- ← Puna me në fokus grupet u përqendrua në dy aspekte:
- ← Rreth konceptit të tyre mbi teoritë arsimore,
- ← Strategjive që zhvillohen në mësim lidhur me tre qasjet kryesore: bihevisoriste, konjitiviste dhe konstruktiviste.

Rreth konceptit mbi teoritë arsimore,

Biseda u zhvillua rreth problematikës:

- ← Teoritë arsimore bazë, vendi dhe roli i tyre në kurrikul, mësimdhënie dhe nxënie
- ← Qasja me qendër nxënësive në kontekstin e teorive arsimore bashkëkohore
- ← Përvoja nga mësues që kanë qasje më të mirë ndaj filozofive dhe teorive arsimore, duke krahasuar rentabilitetin e tyre në shkollë me ata që bazohen në përvoja empirike.
- ← Evidentimi i teorive që gjejnë zbatim më shumë apo më pak në mjediset tona arsimore?
- ← Çfarë ndikimi kanë teoritë arsimore në marrëdhëniet midis: nxënësve, mësues - nxënës, prindër- fëmijë, prindër -shkollë?
- ← Formimi që kanë marrë mësuesit në fakultetet dhe nga trajnimet, lidhur me teoritë arsimore.

Çështjet u ndoqën me interes. Kjo sepse informacioni teorik, i bazuar në praktika konkrete shkollë mundëson që nxënësit të motivohen për të mësuar më mirë, për t'u ndjerë më mirë, për të klasifikuar nxënësit sipas niveleve, për të rritur performancën e tyre akademike dhe qytetare.

Me gjithë interesin, evidentohet se konceptet zbatohen më shumë në mënyrë empirike. Kjo sepse nxënësit por edhe mësuesit nuk studiojnë sa duhet për të arritur në kuptimet të thella për të trajtuar veprimtarinë mësimore edukative, sipas qasjeve dhe modeleve teorike.

Të mësuarit e planifikuar, me synime dhe objektiva të matshëm, sipas qasjeve bihevisoriste dhe konjitiviste krijon lehtësi në organizimin e mësimit dhe vlerësimin e nxënësive. Ndërsa metoda me në qendër nxënësive, me të menduarit kritik dhe krijues aktualisht janë më tepër një prirje se sa një zbatim konkret i koncepteve të teorive bashkëkohore. Nxënësive shprehën më së shumti për zbatimin e teorisë së Maria Montesorit, pasi kështu mendojnë se u krijohen më shumë hapësira, por nga intervistat gjysmë të strukturuar del se ata nuk e kuptojnë qartësisht këtë në prizmin e filozofisë arsimore ekzistencialiste, që lirinë në të mësuarit e lidh pazgjidhshmërisht me përgjegjësinë për të marrë përsipër detyra në veprimtarinë e secilit.

Nga diskutimi i lirë me fokus grupet rezultojnë se më shumë hapësirë në shkollë gjejnë: Taksonomia e Blumit, kryesisht sipas niveleve të ulëta dhe të mesme të vlerësimit; Inteligjenca shumëfishe e Gardnerit në përcaktimin e prirjes së fëmijës; Piramida e nevojave të Maslout; Konceptet bihevisoriste mbi marrëdhëniet dhe përforsimin; konceptet konjitiviste mbi përkufizimet, klasifikimin e njohurive, konceptet konstruktiviste mbi vënien në efikasitet të përvojës për të sendërtuar kuptime dhe qëndrime të reja në situata të ndryshme, idetë e Djuitt, mbi zgjerimin e konceptit mbi të mësuarit dhe demokratizimin e marrëdhënieve, e kështu me radhë.

Nga vëzhgimet në klasë rezultojnë se mësuesit reflektojnë dobësi në ndjekjen e koherencës mësimore, e cila nis nga konceptimet filozofike e teorike, përvijon me metodologjitë, metodat, teknikat dhe procedurat përkatëse. Më së shumti aspekti teorik dhe praktik trajtohen si dy linja më vete dhe metodologjia nuk realizon si duhet sintezën e tyre. Kësisoj, teoritë arsimore mbeten më së shumti në aspektin e artikullimit të rëndësive që kanë, se sa të efikasitetit në praktikën e përditshme dhe më gjerë. Kjo bën që, me gjithë përpjekjet e vazhdueshme, orientimet dhe trajnimet, programi mësimor të mos përveçsohet në mënyrë koherente, sipas synimeve, objektivave, metodologjive, standardeve të përmbajtjes dhe të arritjeve, mënyrave të vlerësimit bashkëkohor.

Strategjitë e mësimit, sipas teorive bihevisoriste, konjitiviste dhe konstruktiviste

Përmbushja e detyrave në shkollë kërkon jo vetëm njohjen e teorive por edhe hartimin e strategjive efektive sipas teorive. Në literaturën pedagogjike dhe në praktikat mësimore qasjet arsimore shpesh ndërthuren me mjera tjetër. Qasja konstruktiviste realizohet nëpërmjet ndërthurjes së elementeve të teorive, që nga ato bihevisoriste tek ato konjitiviste dhe më gjerë. Në studim u përdorën pyetjet më poshtë, që Charles M. Reigeluth⁹, në artikullin – “Cila është paradigma e re e teorive të të mësuarit”, shtron në lidhje me efikasitetin e qasjeve bihevisoriste, konjitiviste dhe konstruktiviste, të cilat janë:

- ← Cilat janë anët e forta dhe të dobëta të teorive arsimore?
- ← Si mund të planifikohet mësimi mbi bazën e tyre?
- ← Si ndryshon të mësuarit?

← Profesori i universitetit të Indianës në SHBA

- ← Cili është procesi i përfitimit të dijes, apo si mëson nxënësi?
- ← Si ndihet nxënësi?

Nga diskutimet e bëra në fokus grupe u evidentua:

- ← *Mbi anëve të forta dhe të dobëta të tre teorive arsimore.* Jeta është shumëdimensionale dhe një përgatitje e bazuar në marrëdhënien stimul – reagim, që ofron qasja biheviariste, mund të mos shfaqet. Gjithsesi një mënyrë e tillë të mësuarit e mundëson dhe e përshtat sjelljen e nxënësit. Po ashtu, edhe të mësuarit konjitivist i fokusuar në rregulla e përkufizime strikte ka mangësitë e saj në një botë të sofistikuar, më e gjerë se sa korniza e rregullave mësimore, ashtu sikurse, nga ana tjetër, ka avantazhin se është më lehtë për t'u përshtatur me rregullat dhe kjo njerëzve u krijon qetësi. Midis qasjeve objektivist (biheviariste dhe konjitiviste) dhe qasjes subjektiviste, konstruktivist ka një analogji me teorinë e Kohlbergut mbi zhvillimin moral parakoncepcional dhe postkoncepcional. Kjo sepse konstruktivisti e ka të vështirë për të menduar dhe reaguar në një mënyrë procedurale të paravendosur, e cila duhet zbatuar pa mëdyshje. Por, nëse, nga njëra anë, zbatimi i metodave strikte mund ti hap probleme një konstruktivisti, në një mjedis social të strukturuar, nga ana tjetër, të ambientuarit në situata të ndryshme e mundëson atë për t'u përshtatur më mirë në një mjedis që i kalon muret e shkollës.
- ← *Mbi planifikimin e mësimit.* Në qasjet objektivist mësimi planifikohet mbi bazën e synimeve, objektivate, duke ju përmbajtur kriterëve përkatëse të paracaktuara. Biheviarizmi ndjek një stil të analizuarit të dukurive, objektivat i fokuson tek sjellja, sepse të mësuarit konsiderohet ndryshim në sjellje. Përsa i përket objektivate, të njëjtin qëndrim mban edhe konjitivizmi, por në ndryshim, qasja konjitiviste, të mësuarin e trajton si produkt dhe ndryshim në mendësi. Të dyja qasjet objektivist e trajtojnë procesin e të mësuarit në një rrjedhë të bazuar në ndjekjen e sekuencave të mësimit. Përsa i përket vlerësimit, parapëlqehet vlerësimi i procesit, i ndjekjes së sekuencave të mësimit. Ai bazohet në arritjet që janë përcaktuar në planifikimin biheviarist, sikurse mendohet në njërin qasje, apo logjik, të bazuar tek reflektimi, sikurse bëhet në tjetrën. Mësuesi bën vlerësimin e arritjeve, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara që më parë, me synim arritjen e objektivate. Në qasjen konstruktivist analiza fokusohet jo tek procesi, por tek produkti, në atë që duhet të bëj nxënësi, duke përdorur në mënyrë efikase mjetet dhe mjedisin që duhet të përdor. Objektivat e të mësuarit janë përgjithësisht rrjedhojë e nismës së nxënësit dhe e shqyrtimit të tyre me mësuesin, të bazuara në atë që nxënësi do të realizojë. Procesi i të nxënësit është vetërregullues, i orientuar nga arritjet dhe jo nga ndjekja në mënyrë strikte e sekuencave klishe. Vlerësimi bazohet në vetëvlerësimin. Për sa i përket të mësuarit, nxënësi përdor situata të ndryshme të mësuarit në funksion të produktit.
- ← *Modelet e të mësuarit.* Në qasjen biheviariste zbatohet metoda e lidhjes shkak – pasojë, të mësuarit fokusohet në fitimin e sjelljeve të kushtëzuara të nxënësit. I kushtohet rëndësi përforcimit, qëndrimit ndaj dukurive të sjelljeve, si në rastet kur duhet zbatuar teknika e lavdërimit, ashtu edhe kur duhet përdorur qortimi me synim korrigjimet e nevojshme nga mësuesi kundrejt nxënësit. Në qasjen konjitiviste të mësuarit fokusohet në vënien në efikasitet të proceseve mendore. Në të dyja qasjet, të mësuarit bazohet tek modeli i realitetit dhe të mësuarit është në funksion të përdorimit. Nga njëra qasje në tjetrën krijimi i realitetit të nxënies zhvendoset nga një mjedis unik, në një mjedis më të përgjithshëm. Edhe në qasjen konstruktivist, ashtu si në atë konjitiviste, synohet vënia në efikasitet e proceseve mendore, por kjo realizohet duke mbajtur parasysh hapësirën që krijon qasja konstruktivist, për përdorimin e modeleve fleksibile, sipas situatave të mësimit.
- ← *Përsa i përket përfitimit të dijes.* Në konceptin biheviarist dija është në varësi të ndryshimit në sjellje, ndërsa në konceptin konjitivist dija, të mësuarit është ndryshim në mendësi. Në të dy rastet dija vjen nga ndjekja e rregullave, të cilat normojnë dhe krijojnë kushte për t'u përshtatur dhe mësuar, në realitete të dhëna. Dija arrihet vetëm në mënyrë graduale, ku ndryshimet nga skemat e parapërgatitura janë të pakta. Kontrolli i njohurive bazohet në arritjet në sjellje apo mendësi. Në qasjen konstruktivist nxënësi vlerëson si ndryshimet në mendësi ashtu edhe ato në sjellje, duke u fokusuar në vetërealizimin e nxënësit, në qëndrimin kritik mbi arritjet dhe mosarritjet, ku dhe gabimet konsiderohen një rast për të reflektuar dhe mësuar. Kontrolli i arritjeve gjykohet mbi ndryshimet që kanë ndodhur së brendshmi tek nxënësi në funksionimin e skemave dhe hartave mendore, që janë fleksibile, jo thjesht si në qasjet objektivist, ku veprimet ndjekin domosdoshmërisht rregullat përkatëse. Të mësuarit është ndryshim në përvojën e mëparshme, si rrjedhojë e aftësive për të ndjekur realitetin dhe informacionin e ri.
- ← *Si ndihet nxënësi?* Në qasjet e para nxënësi përgjithësisht është në një gjendje pasiviteti, thjesht duke interpretuar realitetin. Kjo sepse në këto qasje nxënësit nuk i lihen shumë hapësira për të vepruar. Atij i duhet të veprojë në përshtatje me synimet dhe objektivat biheviariste të sjelljes apo që janë përcaktuar në aspektin njohës, sipas qasjes konjitiviste. Kësisoj, nxënësi mëson dhe përshtatet për të vepruar si automat, në funksion të sjelljeve apo për të kujtuar atë që duhet të mësojë. Ndërsa në qasjen konstruktivist, nxënësi ndihet mirë, duke qenë se mendon dhe vepron në mënyrë aktive. Ai sendërton herë pas here skema në mendjen e tij. Kështu, ai zgjeron dhe thellon kuptimin mbi realitetin, duke u përgatitur dhe vepruar aktivisht për situata të reja. Për rrjedhojë ai zhvillon aftësitë mendore, krijuese, mban qëndrim kritik, duke u përshtatur dhe përgatitur për të përballuar sfida, në realitete të ndryshme, sikurse ndodh në jetë.

Përfundime/ Rekomandime

Nga studimi rezulton se teoritë arsimore promovojnë vlera, por ato nuk integrohen në mënyrë të natyrshme në shkollë.

Nxënësit dhe mësuesit janë mësuar të punojnë me qasje kryesisht empirike. Kjo për shkak të mangësive si në formimin

filleshtar në përgatitjen nëpër fakultete të mësuesisë dhe licencimit, ashtu edhe përgjatë edukimit të vazhduar të mësuesve, nëpërmjet procesit të trajnimit në vite dhe kualifikimit.

Zbatimi i teorisë arsimore vlerësohet si të domosdoshme në procesin mësimor edukativ. Ato nuk janë një çështje preference dhe luks, por obligim i aktorëve që operojnë në shkollë. Çka kërkon një punë të përkushtuar nga subjektet që trajtojnë problematikën e shkollës për t'u pasqyruar në mënyrë efektive në kurrikul, në mësimdhënie dhe nxënie, duke evidentuar vlerat e tyre për të krijuar një mjedis të përshtatshëm akademik, human, social, që nxënësit të ndihen mirë, si kusht për të mësuar mirë.

Në përfundim do të evidentonim problematikën si më poshtë:

- ← Teoritë arsimore edhe në botë janë integruar me vështirësi në procesin mësimor, por aktualisht ka një rivlerësim të tyre
- ← Në arsimin tonë, teoritë arsimore nuk njihen në thellësi dhe kuptimi mbi vlerat e tyre ka mbetur disi abstrakt
- ← Nuk ka kuptim për përmasat psikologjike, sociale, filozofike, humane, demokratike, për të krijuar kompetenca në fushën e njohurive, aftësive vlerave profesionale dhe qytetare
- ← Ka kuptime mbi marrëdhëniet në shkollë, përforcimin, inteligjencën e shumëfishtë, por nuk janë të qarta rrjedhojat pedagogjike, nuk zbatohet lidhja midis teorisë, avantazhet që krijojnë në konceptimin e kurrikulës, përmbajtjes, koherencës, kuptimit holistik
- ← Sinteza teorike nuk zbatohet me efikasitet në planifikimin dhe zbatimin kurrikular në tërësi dhe për çdo orë, kapitull, apo lëndë
- ← Nxënësit përgjithësisht i pranojnë qasjet e reja, por nuk kuptojnë aq sa duhet efikasitetin e tyre në procesin mësimor, ku liria e zgjedhjes përbën njëkohësisht edhe përgjegjësi për realizimin efikas të detyrimeve shkollore.

Rekomandime

Filozofit dhe teoritë arsimore përbëjnë elementin bazë nga duhet të nis rishikimi i procesit mësimor edukativ. Për të realizuar ndryshimin në arsim duhet:

- ← Teoritë arsimore të reflektohen në mënyrë koherente në Kornizën Kurrikulare,
- ← Specialistët e IZHA ti pasqyrojnë në mënyrë koherente konceptet e filozofive dhe teorisë arsimore në kurrikul
- ← Të pasqyrohen në testet që përgatit Agjencia Kombëtare e Provimeve për të dhënë provime parauniversitare në nivele të ndryshme shkollore
- ← Të pasqyrohen me efikasitet, gjatë kryerjes së arsimit universitar, në fakultetet e mësuesisë, në nivelet bachelor dhe master,
- ← Në provimin që përgatit Agjencia Kombëtare e Provimeve për licencimin për të ushtruar profesionin e mësuesit
- ← Në trajnimet dhe kualifikimet e punonjësve të arsimit, sipas profileve përkatëse
- ← Në trajnimin bashkëkohor të trajnerëve
- ← DAR dhe ZA, dhe institucione të tjera të arsimit, në inspektimet e tyre të shqyrtojnë problematikën e koherencës midis filozofive, teorisë, modeleve, strategjive, teknikave, procedurave që zbatohen në shkollë.
- ← Të përfshihen në mënyrë efektive në planprogramet e supervisorëve të shkollës

Natyrisht që hulumtimi ka edhe kufizime. Megjithatë janë përfshirë në fokusgrupe dhe intervistuar edhe studentë të mësuesisë në të tre nivelet, bachelor, master dhe doktoraturë, kjo kryesisht me ata që studiojnë në UET, hulumtimi do të ishte më i plotë nëse do të kishte një shtrirje dhe përfaqësim më të gjerë. Gjithsesi, ai bazohet në një përvojë të gjatë në këtë fushë dhe nëpërmjet argumenteve tërheq vëmendjen e institucioneve arsimore përkatëse dhe në mënyrë të përshkallëzuar për të reflektuar dhe trajtuar me përkushtim dhe përgjegjësi problematikën e teorisë arsimore dhe vlerave që reflektojnë për shkollën.

Bibliografia

- Anderson, T. (2004). A second look at learning sciences, classrooms and technology. In T. Duffy & J. Kirkley (Eds.), *Learner centered theory and practice in distance education* (pp. 235-249). Mahëah, NJ: Lawrence Erlbaum.
- Carlile, O., & Jordan, A. (2009). The centre cannot hold: Challenging student-centred learning. In L. Carey, H. Guerin, S. Huntley-Moore, S. Magennis, & B. McMillin (Eds.)
- Lombardi, S.M. (2011). *Internet Activities for a Preschool Technology Education Program Guided by Caregivers*. Doctoral dissertation, North Carolina State University. pp. 139-40.
- Devries, B.; Zan, B. (2003). "When children make rules". *Educational Leadership* 61(1): 64-7.
- Illeris, Knud (2004). *The three dimensions of learning*. Malabar, Fla: Krieger Pub. Co. ISBN 9781575242583.
- Jonassen, D. H. Objektivismi kundrejt konstruktivizmit: a kemi ne nevojë për një paradigmë të re filozofike? *Educational Technology Research and Development*, 1991, f. 5-14, 39.
- Kerlinger, Fred N. (1973) *Foundations of Behavioral Research*. 2nd edition. Holt, Rinehart and Winston
- Lea, S. J., D. Stephenson, and J. Troy (2003). Higher Education Students' Attitudes to Student Centred Learning: Beyond 'educational bulimia'. *Studies in Higher Education* 28(3), 321-334.
- Jerome Bruner, (1966) *Toward a Theory of Instruction*, Cambridge, MA: Harvard University Press.

- Jones, Leo. (2007). *The Student-Centered Classroom*. Cambridge University Press.
- Lombardi, S.M. (2011). *Internet Activities for a Preschool Technology Education Program Guided by Caregivers*. Doctoral dissertation, North Carolina State University. pp. 139–40.
- Taylor, J. (2013). What is student-centredness and is it enough? *The International Journal of the First Year in Higher Education*, 4(2). 39-48. doi: 10.5204/intjfyhe.v4i2.168
- Bashkim Peçi (2004) “Konstruktivizmi dhe Teoritë Arsimore”, Tiranë, Shtëpia Botuese Kristalina-KH.
- Shefik Osmani (2014) *Figura të shquara të arsimit dhe pedagogjisë*, Tiranë, Shtëpia Botuese “FILARA”
- Instituti I Studimeve Pedagogjike (2003) *Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar, vëllimi i I*, Tiranë.
- Instituti I Studimeve Pedagogjike (2004), *buletini Filozofi dhe sociologji*, Tiranë, Shtëpia Botuese Kristalina-KH.

Burime nga interneti

Cilësia e Arsimit dhe Mundësitë për Zhvillimin e Aftësive në Shqipëri Analizë e rezultateve të PVNN-së 2000-2012 Qershor 2014, nga <http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Albania/al-pisa-report-al.pdf>

NDIKIMI I MARRËDHËNIES ATASHUESE ME NËNËN NË EDUKIMIN E SJELLJEVE EKSPLORUESE TE FËMIJËT E MOSHËS 5-6 VJEÇ

FLORA LAMCJA (ZEQAJ)

Universiteti Europian i Tiranës, Shkolla Doktorale, Profili Psikologji-

Pedagogji flora.lamcja@yahoo.com

ABSTRAKT

Atashimi është procesi i formimit të lidhjeve emocionale të qëndrueshme midis nënës dhe fëmijës. Kjo lidhje emocionale fillon të zhvillohet që në ditët e para të jetës së fëmijës. Atashimi i shëndetshëm i fëmijës me nënën është bazë për të qenë në vitet e mëvonshme, i sigurt, kurajoz, këmbëngulës e eksplorues në sjelljet e tij. Pikërisht mbi këtë këndvështrim është mbështetur edhe ky studim i realizuar me fëmijët e moshës 5-6 vjeç. Në funksion të studimit janë paraqitur informacione, thënie, hulumtime, ide nga fusha e edukimit dhe e psikologjisë. Bashkëngjitur tyre janë sjellë fakte konkrete, të dhëna, përvoja, nga studimi i kryer te një grup fëmijësh të kësaj moshe. Këto të dhëna janë grumbulluar duke bashkëpunuar ngushtësisht me prindërit, fëmijët dhe edukatorët. Qëllimi i këtij studimi konsiston në faktin se, si ndikon atashimi i fëmijës me nënën në formimin e tij psiko-social dhe në sjelljet eksploruese. Grumbullimi i të dhënave të studimit u realizua nëpërmjet dokumentacionit përkatës për çdo fëmijë, checklistat, intervista gjysmë e strukturuar e realizuar me nënat e fëmijëve të marrë si raste studimore. Eksperimenti nëpërmjet lojës, është një tjetër mënyrë për grumbullimin e të dhënave mbi sjelljet eksploruese të këtyre fëmijëve. Për çdo rast studimor, janë përdorur instrumentet përkatës dhe janë grumbulluar të dhëna mbi mënyrën, se si fëmijët manifestojnë sjelljet eksploruese gjatë veprimtarisë së tyre. Pas grumbullimit të të dhënave u realizua përpunimi i tyre, për të dalë në konkluzione konkrete te studimit të kryer. Nga të dhënat e grumbulluara rezultoi se atashimi i shëndetshëm i nënës me fëmijën ndikon pozitivisht në formimin e tij social e psiko-emocional. Marrëdhënia nënë-fëmijë, luan rol parësor në procesin e formimit multidimensionale të fëmijës, duke ndikuar në botëkuptimin dhe në mënyrën e përshtatjes së tij, me mjedisin shoqëror.

Fjalë kyç: *Atashim, marrëdhënie, fëmijë, sjellje, eksplorues*

Hyrje

Atashimi është një marrëdhënie e rëndësishme e fëmijës me personin kujdestar, që zakonisht është nëna. Në vazhdim të kësaj ideje, çdo foshnjë zhvillon një marrëdhënie atashimi me personat që kujdesen dhe përqipen të përdorin këta persona si burim qetësie dhe sigurie përballë sfidave dhe kërcënimeve që vijnë nga mjedisi. Prezenca e marrëdhënieve atashuese foshnje-kujdestar duhet të jetë universale. Këto marrëdhënie dhe cilësia e tyre ndikohet nga diferencat individuale, që personat shfaqin. Dallimi ndërmjet pranisë së një marrëdhënieje atashimi dhe cilësisë së këtij raporti tejet të ngushtë janë shumë të rëndësishme. Sipas Bowlby foshnja ndërton një marrëdhënie atashimi me kujdestarët për aq kohë sa personi ndërvepron me të dhe formon një figurë atashimi. Fëmijët do të jenë të pa atashuar vetëm nëse nuk do të kenë një kujdestar të qëndrueshëm, si në rastet e fëmijëve të institucionalizuar. (Cassidy. J., & Shaver.P.R, 2008, fq.78)

Përmes ndërveprimeve të përsëritura me të njëjtin person të rritur foshnja fillon të njoh kujdestarin e tij dhe ta konsiderojë atë si kujdestarin primar. Bowlby dhe Ainsworth ishin të parët që shtjelluan intensivisht këto marrëdhënie të hershme. Ata e përshkruan foshnjën të predispozuar biologjikisht për të përdorur kujdestarin që zakonisht është nëna si një “strehë sigurie” dhe si “themel të sigurt” ndërsa eksploron mjedisin (Cassidy.J & Shaver.P.R, 2008, cituar nga Ainsworth,1967; Ainsworth et, al 1978: Bowlby, 1969/1982). Kur fëmija ndjen kërcënimin ai/ajo kërkon përkujdesjen për mbrojtje dhe qetësi. Në fakt Bowlby dhe Ainsworth përshkruan një balancë të foshnjat midis eksplorimit dhe kërkimit të afrimitetit kur eksplorimi rezulton kërcënues.

Konfidenca e një fëmije ndaj përkujdesit të tij, nxit eksplorimin dhe kompetencën, një nocion qendror në teorinë e atashimit. (Cassidy. J., & Shaver.P. R, 2008, cituar nga Bowlby 1969/1982). Gjatë zhvillimit fëmija duhet të ekuilibrojë motivimin eksplorator me frikën e përshtatshme ndaj së resë dhe rrezikut, ndërkohë që njihet me mjedise të reja dhe zhvillon aftësi të reja. Fëmijëria e hershme, e mesme, adoleshenca zgjasin shumë më tepër se sa periudhat e tilla në jetët e kafshëve të tjera. Shumë nga sjelljet eksploruese të njeriut janë lojëra (Cassidy. J., & Shaver.P. R, 2008, cituar nga Lorenz,1977, fq.147). Teoria e Atashimit siguron një intuitë se çfarë është e nevojshme për ta bërë fëmijën të ndihet i sigurt dhe pa tensione; një figurë atashuese mbrojtëse që i përgjigjet, mbështetëse, e besueshme, më e fortë dhe më e zgjuar. Me këtë lloj ushqyerje fëmija ka mundësi të eksplorojë botën në mënyrë konfidente, të nisë ndërveprime sociale të ngrohta me të tjerët dhe të gjejë ngushëllim të kujdestari i tij (Cassidy. J., & Shaver.P. R, 2008, cituar nga Ainsworth, 1978).

Atashimi i nënës dhe fëmijës është një proces jetësor, ku hidhen hapat e para të komunikimit njerëzor. Atashimi është një ndërveprim i bukur dhe harmonik midis nënës dhe fëmijës, është lidhja e parë social-emocionale që krijon fëmija me ambientin që e rrethon. Në këtë proces fëmija fillon lidhjet me jetën, me njerëzit, me gjithçka përreth tij. Studimet e kryera rreth kësaj teme na sjellin informacione se fëmijët e mirë atashuar me nënën janë më social, më të komunikueshëm, më bashkëpunues dhe janë eksplorues në sjelljet e tyre. Mendohet se ata janë fëmijë me zhvillim të mirë si në aspektin fizik, ashtu edhe në aspektin gjuhësor dhe emocional.

Për këtë arsye, kërkimi im është fokusuar tek marrëdhënia atashuese nënë-fëmijë. Vëmendja kryesore është vendosur mbi këtë marrëdhënie të rëndësishme në foshnjëri dhe po aq të rëndësishme edhe në vazhdimësi. Kjo marrëdhënie në këtë studim, nuk është parë e vetme, por e lidhur ngushtësisht me një aspekt të zhvillimit të fëmijëve, eksplorimin. Të qenit eksplorues, siç do të shpjegohet më gjerësisht në studim, do të thotë të kesh vet-siguri, të jesh i përqendruar në atë çfarë bën, të përballësh dhe përshtatesh lehtësisht me situata familjare dhe jo familjare, të kesh aftësi ndërvepruese dhe vet-kontrolluese si dhe të jesh në të njëjtën kohë edhe autonom. Këto dhe disa karakteristika të tjera përbëjnë atë që mund ta konsiderojmë atashim të plotë e të shëndetshëm.

Qëllimi

Qëllimi i këtij studimi është të vështrojë nga afër dhe në mënyrë të detajuar sjellje, veprime e ndërveprime, komunikim e eksplorim të fëmijës, në situata të ndryshme dhe ndikimi që ka marrëdhënia atashuese e fëmijës me nënën, tek sjelljet e tyre. Qëllimi im është të eksplorojë sjelljet e tyre në ambientet e kopshtit, si ndërtonin marrëdhëniet me të tjerët, sa të afuar janë me njerëz të panjohura, sa duan të mësojnë dhe të kenë kontakt me ta, sa kurioz dhe sa këmbëngulës janë për të arritur qëllimin e tyre. .

Ky vëzhgim do të bazohet në karakteristikat eksploruese të fëmijës: qëndrueshmëria, vëmendja, kurioziteti, përballja me sfidat dhe situatat jo familjare, reagimet dhe ndërveprimet e fëmijës me nënën, fëmijët e grupit, edukatorët, dhe me mua tek karakteristikat e marrëdhënies që ka me nënën.

Objektivat e studimit

- ← Të vlerësojë rolin dhe rëndësinë e atashimit të nënës me fëmijën, në rastin konkret fëmijët e moshës 5-6 vjeç.
- ← Të zbulojë lidhjen e atashimit të fëmijës me sjelljet eksploruese të tij.
- ← Të zbulojë shkaqet dhe arsyet e mungesës së sjelljeve eksploruese të fëmijët e moshës 5-6 vjeç.
- ← Të evidentojë rëndësinë e roleve gjinore në zhvillimin e sjelljeve eksploruese te fëmijët.

Gjithashtu objektiv i studimit nuk është vetëm evidentimi i kësaj lidhje, por edhe ndërtimi i mënyrës se si duhet të punohet me ata fëmijë të cilët nuk janë eksplorues dhe nuk kanë të zhvilluar këtë sistem sjelljeje mjaft të rëndësishëm për zhvillimin e përgjithshëm.

Pyetja kërkimore

- ← Cili është roli i atashimit të nënës me fëmijën në zhvillimin e sjelljeve eksploruese të fëmijët e moshës 5-6 vjeç.
- ← Si ndikon atashimi i nënës me fëmijën në zhvillimin e tij psiko-social.
- ← Si ndikojnë rolet gjinore në sjelljet eksploruese të fëmijëve.

Hipoteza

Fëmijët e mirë atashuar me nënën kanë zhvillimi të mirë psiko-emocional, janë bashkëpunues, janë eksplorues në sjelljet e tyre, janë të komunikueshëm, janë kurioz për të zbuluar të rejtat e botës që i rrethon. (Në rastin konkret i referohemi fëmijëve të moshës 5-6 vjeç.)

Metodologjia e punimit

Për të arritur qëllimin e këtij studimi është realizuar një vështrim i thellë dhe i detajuar në disa sjellje, ndërveprime dhe mënyra të funksionimit të fëmijës në situata të ndryshme në ambientet e kopshtit dhe lidhjen që ato kanë me marrëdhënien atashuese që fëmija ka me nënën. Ky vëzhgim do të bazohet tek karakteristikat eksploruese të fëmijës: qëndrueshmëria, vëmendja, kurioziteti, përballja me sfidat dhe situatat jofamiljare, reagimet dhe ndërveprimet e fëmijës me nënën, fëmijët e grupit, karakteristikat e marrëdhënies që ka me nënën, duke përdorur metoda efikase të përshkruara më poshtë.

Gjithashtu objektiv i studimit nuk është vetëm evidentimi i kësaj lidhje, por edhe ndërtimi i mënyrës se si duhet të punohet me ata fëmijë të cilët nuk janë eksplorues dhe nuk kanë të zhvilluar këtë sistem sjellor, mjaft të rëndësishëm për zhvillimin e përgjithshëm.

Janë respektuar të gjitha çështjet etike, duke siguruar lejen e nevojshme nga prindi fëmijës dhe në bashkëpunim me edukatoren e grupit. Për realizimin e këtij studimi është përdorur shqyrtim literature (literatura e nevojshme për shpjegimin e fjalëve kyç si dhe studime të ngjashme që lidhen me çështjen time kërkimore që e mbështesin atë).

Studim rasti (shqyrtim i dokumentacionit të fëmijës, listë-kontrolli për fëmijën, plotësuar nga nëna si dhe intervistë gjysmë e strukturuar me nënat).

Listë-kontrolli është një instrument që përmban një listë me tema, objektiva, aftësi, njohuri për të cilat individit do të vrojtohet. Qëllimi kryesor i listë-kontrollit është të regjistrojë një vlerësim të vazhdueshëm për ecurinë e dukurisë që vrojtohet tek një individ duke dëshmuar se si i përmbush ai detyrat ose objektivat e llojeve të ndryshme (Mita.N., "Instrumentet e matjes", Moduli 2, fq. 7). Kjo listë-kontrolli ka si qëllim të vëzhgojë dhe të masë karakteristika të caktuara të sjelljes së fëmijës që lidhen me eksplorimin. Në bazë të kërkimeve të bëra lidhur me këtë koncept dhe veçoritë që e përbëjnë unë jam ndalur në disa karakteristika që mendoj se janë të rëndësishme, të cilat janë: 1. *Qëndrueshmëria e fëmijës gjatë kryerjes së një aktiviteti/loje dhe gjatë ndërveprimit me objektin/lodrën.*; 2. *Kontakti me sy që mban me objektin/lodrën që po luan, ose në rastet kur pranë tij është një person tjetër që sugjeron zhvillimin e lojës.*; 3. *Aftësitë dhe kompetencat e fëmijës të manifestuara në disa sjellje që ai zhvillon (të genit i vet-sigurt).* 4. *Ndërveprimi me shokët/shoqet dhe reagimet gjatë aktiviteteve të ndryshme.*

Në listë-kontroll këto janë të specifikuar në zëra të cilët pasqyrojnë sjellje të caktuara që fëmija i bën, nuk i bën, ose nuk i bën plotësisht. Krahas specifikimit të këtyre sjelljeve, në krahe të tyre është edhe shkalla matëse, që tregon frekuencën e këtyre sjelljeve të performuara nga fëmija, si dhe komente nëse rezultoni e nevojshme të specifikohet ndonjë karakteristikë që tërheq vëmendjen.

Intervista gjysmë e strukturuar:

Kjo intervistë është një ndër instrumentet që kam përdorur për të eksploruar marrëdhënien atashuese që nëna ka me fëmijën dhe këndvështrimin i saj mbi eksperiencën e mëmësisë. Në këtë intervistë do të përshkruhen elementët thelbësor që shprehin atashimin me nënën.

Pyetjet e përdorura në intervistë, janë të strukturuar në mënyrë të atillë që të japin një sasi të mjaftueshme informacioni mbi ndjesitë e nënës nga momenti i zbulimit të shtatzënisë e deri në moshën aktuale të fëmijës. Secila prej pyetjeve ndjek një logjikë kronologjike. Ato janë të koduara me qëllim analizimin e informacionit dhe arritjen tek gjetjet e studimit.

Eksperimenti (një grup lojërash që kanë si qëllim evidentimin e sjelljes eksploruese të fëmijës, ndërveprimin, qëndrueshmërinë, këmbënguljen për ta finalizuar lojën. Janë zhvilluar 3 lojëra të ndryshme formuese, të ndara në 4 faza dhe të zhvilluara në ditë të ndryshme nga secili fëmijë). Eksperimenti që unë kam zhvilluar ka pasur në fokus studimin e sjelljes së fëmijëve gjatë zhvillimit të lojërave. Këto lojëra janë aplikuar tek secili nga fëmijët përgjatë periudhës së qëndrimit në kopsht. Të gjitha lojërat janë zhvilluar në kopsht, gjatë orarit të aktivitetit të lirë dhe pjesëmarrja në to, është zhvilluar në marrëveshje me nënën, fëmijën, dhe edukatoren. Lojërat janë të dokumentuara nëpërmjet disa filmimeve që bashkëlidhen me këtë studim.

Këto filmime më kanë dhënë mundësinë të përpunojë më mirë të dhënat e marra, të kem më shumë fakte reale si dhe të kem më shumë informacion për aspektin verbal, joverbal, reagimet, përqendrimi, koha e realizimit të aktivitetit, mënyra e ndërveprimit me mua, kontakti me sy dhe fizik që ka fëmija me mjetet e lojës dhe me mua, si dhe ajo çfarë është shumë e rëndësishme si kanë ndryshuar sjelljet dhe reagimet e fëmijës nga loja e parë në lojën e fundit. Lojërat janë zhvilluar në një cep të klasës, pa praninë e personave të tjerë, përveç meje dhe fëmijës. Për realizimin e tyre është nevojitur një tavolinë (në formën rrethore), 2 karrige dhe mjetet që nevojiten për lojën.

Mendoj se ka disa faktorë që kanë ndikuar (pozitivisht, negativisht) në realizimin e eksperimentit dhe mund të përmend: dëshira e fëmijës dhe kënaqësia që merr nga realizimi i këtyre lojërave; ndryshimi i rutinës ditore të fëmijëve; gjendja emocionale e fëmijës para eksperimentit; zhurma të fëmijëve në kopsht, pasi ishte e pamundur që të izoloheshin plotësisht.

Lojërat u përzgjedhën pas një vëzhgimi të vëmendshëm dhe të vazhdueshëm të preferencave të fëmijëve dhe gjithashtu duke u bazuar në informacionet e marra nga edukatorët e grupit, pasi ato kanë eksperiencë më shumë për punën me fëmijët. Për secilin nga lojërat janë matur elementë të ndryshëm që përbëjnë sjelljen eksploruese të fëmijës si dhe qëllimi i aplikimit të tyre, ishte të sillte një profil më të qartë për secilin nga fëmijët dhe një përshkrim të sjelljes së tij gjatë lojërave që na çon në analizim dhe në konkluzione të cilat lidhen me pyetjen kërkimore.

Është e rëndësishme të theksohet se nëpërmjet lojës, që është një ndër aktivitetet që ofron mundësi që fëmija të argëtohet dhe të mësojë njëkohësisht, mund të eksplorohet më shumë dhe të përftohen gjithashtu edhe të dhëna më objektive dhe reale. Kam zgjedhur pikërisht lojërat për të zhvilluar eksperimentin duke iu referuar studimeve të ndryshme që janë paraqitur në shqyrtimin e literaturës të trajtuar në kapitullin numër 1.

Përmbledhja e të dhënave, analizë

Nga ky studim i kryer u mblodhën të dhëna e fakte si nga listë-kontrollet, eksperimenti dhe intervista me nënat.

Listë-kontrolli, ky instrument e ndan atashimin në 4 llojet e tij dhe secila prej tyre ka nga 10 karakteristika të caktuara. Shkalla matëse e tij është e ndarë në 2 grupe: Po dhe Jo, nëse është e tillë ose jo për secilin nga fëmijët. Të dhënat janë akumuluar dhe do të paraqiten në tabelë për secilin nga fëmijët.

TABELA, NR.1.

Nr. i checklistës	Përgjigje pozitive (totali)	Përgjigje negative (totali)
I	13	27
II	27	13
III	28	12
IV	13	27
V	14	26
VI	26	14

Në tabelën numër 1. janë paraqitur numri total i përgjigjeve (pozitive dhe negative) të akumuluar gjatë plotësimit të *checklistës* nga nënat e fëmijëve. Nga mbledhja e këtyre përgjigjeve mund të krijohet një ide e përgjithshme për stilin e atashimit që kanë këta fëmijë me nënat e tyre. Më poshtë do përmbledhen përgjigjet e secilit prej fëmijëve se në cilën kategori kanë qenë përgjigje pozitive dhe në cilën negative. Emërtimi i secilës prej listë-kontrolleve do zhvillohet mbi bazën e numrave që kanë në tabelë.

Duke iu referuar përgjigjeve të dhëna, konfirmohet që nënat ishin objektive dhe nuk iu shmangën qëllimit të studimit. Kjo gjë vlerësohet nga koha e reagimit ndaj pyetjes, që do të thotë se përgjigjet ishin të menjëhershme dhe në kohë të shkurtër. Këto përgjigje të shkruara më lartë, janë të përputhshme me rezultatet e marra nga *checklista* e plotësuar përsëri nga nëna dhe nga vëzhgimet që kam bërë gjatë qëndrimit në kopsht.

Intervista ishte e vlefshme për një njohje më të mirë të atashimit të fëmijës me nënën, si ka influencuar në zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës. Gjithashtu ajo që u përftua me këtë instrument, ishte dhe aspekti emocional që paraqet nëna gjatë zhvillimit të intervistës. U konstatua fakti se mënyra e përjetimit të këtyre etapave të rëndësishme të eksperiencës së saj si nënë, i janë transmetuar edhe fëmijës pasi mund të dallohen mjaft aspekte emocionale të fëmijës të përputhshme me nënën (p.sh., përjetimi me entuziazëm i gjërave të reja, mos përjetim në nivele të larta të frikës dhe menaxhim më të mirë të emocioneve në situata stresuese). Hipoteza e ngritur në fillim të këtij studimi u përforcua dhe u konfirmua nga të gjitha të dhënat e marra. Ky instrument ka pasuruar studimin me elemente reale si shprehje dhe emocione të përdorura nga nënat. Kjo më jep mua si kërkuese një shtysë më tepër për të arritur në konkluzione konkrete. Të punuarit me fëmijët gjatë kësaj periudhe më ka bërë të zbuloj se ka shumë për të mësuar prej tyre si dhe ata janë selektues në atë çfarë zgjedhin për të shfaqur. Qëllimi im ishte të shihja, se si ndikon atashimi i nënës me fëmijën, për të reflektuar në mjedis, siguri dhe kurajo për bashkëveprim. Të eksploroja sjelljen e tyre në ambientet e kopshtit, si ndërtonin marrëdhëniet me të tjerët, sa të afruar janë me njerëz të panjohur, sa duan të mësojnë dhe të kenë kontakt me ta, sa kurioz dhe sa këmbëngulës janë për të arritur qëllimin e tyre. Kopshti është një mjedis që të ofron në mënyrë natyrale të shikosh të gjithë këta elementë të gërshetuar tek secili nga fëmijët.

Por midis tyre ka diferenca, pasi secili është unik, ka individualitetin e tij në mënyrën se si sillet, si reagon, cilat janë qëndrimet e tij dhe si i përjeton ai ngjarje dhe situata të ndryshme. Fëmijët e zgjedhur në studim, përfaqësojnë secili karakteristikat personale dhe sa të ngjashëm duken, aq të ndryshëm janë në të vërtetë. Ata janë pothuajse në të njëjtën moshë, janë pjesë e një grupi, ndërveprojnë ca më pak e ca më shumë me njëri-tjetrin dhe shkëmbejnë eksperiencat e tyre, janë produkte të profileve të ndryshme familjare, të cilat mbartin me vete histori, ngjarje dhe dinamika. Të gjitha këto kanë ndikuar në atë çfarë fëmija është, dhe çfarë ai përfaqëson. Duke mbetur tek dinamikat familjare, një ndër konkluzionet e studimit është potenciali që ka familja për të influencuar fort në jetën e një fëmije dhe se si mund të modifikojë çdo zhvillim të tij. Në rastet që u paraqitën në studim 2 prej fëmijëve të cilët ishin rritur në një mënyrë të ndryshme, si pasojë e mungesës së njërit prind, manifestonin karakteristika të ndryshme nga 4 fëmijët e tjerë të cilët jetonin me të dy prindërit. Nëse do ta lidhim këtë me atashimin, do të shtoja se mungesa e njëjës figurë atashuese shumë të rëndësishme (babait) dhe pasja e një figure tjetër atashuese primare (nënës) që ka në përgjegjësitë e saj përveç të qenit nënë, sigurimin e të ardhurave, përkujdesjen ndaj vetes si femër, rritjen profesionale, të qenit individ social, e vështirëson akoma më shumë “mbijetesën” e shëndetshme të fëmijës dhe nuk i jep atij sigurinë e nevojshme për të plotësuar nevoja të tjera të zhvillimit. Në rastin konkret këta fëmijë ishin vendosur në shoqëri të veshur nga shumë pasiguri të ndryshme që i bënin të sillshin në po të njëjtën mënyrë. Mund të vëresh në shikimin dhe sjelljen e tyre paqëndrueshmëri, frikëra dhe pavendosmëri në sjelljen e tyre. Teoria e mbrojtur në këtë studim bazohet në mënyrën se si atashimi influencën atë që fëmija është, duke filluar nga momenti i perceptimit të shtatzanisë nga nëna e deri në kalimin e të gjitha fazave të zhvillimit të fëmijës. Vendosa të fokusohem më thellë tek këto dy nëna, në bazë të intervistës së realizuar me to dhe mënyrës se si ato e perceptonin shtatzaninë (të frikësuar dhe me ankth) dhe kjo paraqet gjithashtu edhe shfaqje të një atashimi jo të shëndetshme me fëmijët. Nënata në fjalë, janë ndër të frikësuar dhe të vetmuar, si pasojë e mungesës së partnerit dhe mos mbështetjes psikologjike. Moshja e tyre e re, pasiguria ekonomike, pjesa e një roli kaq të rëndësishëm, bënë që dy nënat në fjalë të jetonin me ankth, frikë dhe pasiguri, atë që duhet të jetë eksperiencia më e bukur në jetën e një femre. Ky ankth reflektohet edhe gjatë rritjes së fëmijës dhe mënyrës së atashimit që ajo ka me fëmijën e saj.

Përsa u tha më lart, të gjithë këta faktorë kanë ndikim të pashmangshëm në sjelljen e fëmijës. Këta fëmijë kanë diferencim më të madh nga bashkëmoshatarët. Ata janë më pak ndërveprues, nuk shfaqin kuriozitet për të eksploruar mjedisin përreth, kanë vështirësi në socializim, pasi janë më të tërhequr dhe të pasiguritë në vetvete. Të gjitha këto sjellje rezultojnë qartë edhe nga të gjitha metodat që unë kam përdorur për të arritur në këto gjetje. Në asnjë çast këta fëmijë nuk merrnin rolin e iniciuesit në aktivitetet, por ishin më shumë vëzhgues dhe më pasiv. Pasiguria në vetvete, bënte që ata të kishin vështirësi në marrjen e iniciativës, në përballimin e situatave jo të njohura dhe në përballimin e sfidave. Reagimet e tyre janë konfuziteti, të pakontrolluara dhe shpeshherë reagojnë me zemërim. Përpjekjet e tyre të vazhdueshme, për të pasur vëmendjen e njerëzve që i rrethojnë, vëmendje që i ka munguar në familje, shprehen me tentativën e “*të mbyllurit në vetvete*” dhe “*të tërhequrit nga aktiviteti*”.

Edhe në raportet me bashkëmoshatarët dalin në pah karakteristikat e lartë përmendura. Gjatë zhvillimit të lojërave në grup, këta fëmijë, shfaqin mungesa në aftësitë eksploruese pasi konfuzionohen më shumë, nuk përqendrohen dhe nuk janë të gatshëm për bashkëpunime me bashkëmoshatarët. Për më tepër, ata kanë tendencën të ndjekin rregullat e vendosura nga të tjerët pa negociuar me ta, pa shfaqur interesat dhe pëlqimet e tyre. Kjo shfaqet edhe gjatë lojërave në grup, kur atyre iu caktohet një rol, ata e pranojnë këtë në heshtje pa shprehur preferencat e tyre. Kjo shpreh mungesë të aftësisë eksploruese tek fëmija. Frika, pasiguria vetëvlerësimi jo shumë i lartë dhe mungesa e përqendrimin, bëjnë që ata të shfaqin më pak interes kundrejt gjërave të reja. Elementët e rinj dhe ndryshimet rutinave ditore, frikësojnë. Mendoj se kjo lidhje ka baza të hershme, në frikën që nëna ka përjetuar në momentin e shtatzanisë dhe vazhdon të përjetojë me rritjen e fëmijës. Një nënë e pasigurt dhe që i dedikon pak kohë fëmijës së saj, nuk arrin dot të transmetoj, ndonëse do të dëshironte, siguri tek fëmija.

Më poshtë do të paraqiten të dhënat e marra nga secili grup fëmijësh dhe diferencat gjinore lidhur me aftësitë eksploruese përkatëse. Këto të dhëna janë akumuluar sipas mënyrës dhe strategjive që fëmijët kanë përdorur për plotësimin e figurës me *lego*.

Karakteristikat e vajzave:

- ← Jo shumë ndërvepruese me njëra – tjetrën dhe pak të përqendruara në elementët e lojës, më shumë të fokusuar në detaje dytësore
- ← Gjatë zhvillimit të lojës, kanë më shumë komunikim verbal dhe shprehin më shumë entuziazëm.
- ← Janë më këmbëngulëse dhe kanë më shumë durim në gjetjen e zgjidhjes për bashkimin e pjesëve.
- ← Mbajnë kontakt me sy me njëra-tjetrën.
- ← Nuk arrijnë të finalizonin lojën. U impenjuan në lojë për 25 minuta dhe filluan të shpërqendroheshin dhe dëshironin të largoheshin.
- ← Gjatë lojës së zhvilluar nga vajzat, dy prej tyre që vinin nga familje të rregullta, pa probleme sociale e ekonomike ishin më të përqendruara në lojë, ndërsa vajza që rritej nga prindër të divorcuar kishte dëshirë të komunikonte me mua për lojën dhe pyeste vazhdimisht “*Po pas kësaj lojës, do bëjmë lojëra të tjera?*”. Vajzat gjithashtu i referoheshin instruksioneve të lodrës, por e kishin të vështirë të negocionin me njëra-tjetrën për gjetjen e zgjidhjes dhe nervozoheshin, kur nuk gjenin pjesën e duhur.

Karakteristikat e djemve:

- ← Djemtë janë më ndërveprues dhe të gatshëm për të ndihmuar njëri-tjetrin.
- ← Janë të përqendruar në aktivitetin që zhvillojnë dhe këmbëngulës në arritjen e rezultatit.

- ← Kanë më pak komunikim verbal gjatë lojës dhe më pak kontakt me sy me njëri-tjetrin dhe e mbajnë kontaktin më shumë me elementët e lojës.
- ← Ata arritën të ndërtonin lodrën për tridhjetë minuta dhe ishin shumë entuziastë në përfundimin e saj.

Edhe pse ka dinamika familjare të ngjashme, ekzistojnë diferencime midis sjelljes së djemve dhe vajzave. Ajo çfarë u vëzhgua gjatë zhvillimit të lojërave, ishte një mungesë përqendrimi dhe iniciative më e theksuar tek vajzat se tek djemtë. Vajzat rezultuan më pak këmbëngulëse në arritjen e rezultatit dhe shpërqendroheshin më lehtë nga stimujt mjedisor. Vajzat janë më të përqendruara në bashkëbisedim, sesa në arritjen e objektivit të lojës. Djemtë kanë aftësi më të mëdha eksploruese, janë më të përqendruar, mbajnë kontakt më shumë me objektet/lodrat dhe nuk shpërqendrohen lehtë nga stimujt mjedisor. Ky kërkim mund të pasurohet edhe me kërkime të tjera të cilat mund të konfirmojnë ose rrëzojnë hipotezën tuj.

Gjetjet e studimit

Mbështetur në studimin e bërë kolaudam se atashimi i nënës me fëmijën, apo me një person tjetër që kujdeset për të është një proces i rëndësishëm, që ndikon në zhvillimin psiko-social të fëmijës. Gjithashtu u konstatua se në procesin e atashimit të shëndetshëm të nënës me fëmijën, ndikojnë disa faktorë, që kanë të bëjnë me gjendjen emocionale të nënës. Situata të ndryshme sociale si gjendja ekonomike, papunësia, divorci, marrëdhëniet e vështira në familje ndikojnë negativisht dhe rëndojnë gjendjen emocionale të nënës, duke u bërë shkak për një marrëdhënie jo të shëndetshme, jo të qetë e të ngrohtë me fëmijën. Një nënë e pasigurt, pa një familje të shëndetshme, pa mbështetje ekonomike dhe që i dedikon pak kohë fëmijës së saj, nuk arrin dot të transmetojë, ndonëse do të dëshironte, siguri, ngrohtësi e dashuri tek fëmija i saj. Edhe pse ka dinamika familjare të ngjashme, ekzistojnë diferencime midis sjelljes së djemve dhe vajzave. Ajo çfarë u vëzhgua gjatë zhvillimit të lojërave, ishte një mungesë përqendrimi dhe iniciative më e theksuar tek vajzat se sa tek djemtë. Vajzat rezultuan më pak këmbëngulëse në arritjen e rezultatit dhe shpërqendroheshin më lehtë nga stimujt mjedisor. Vajzat janë më të përqendruara në bashkëbisedim, sesa në arritjen e objektivit të lojës. Djemtë kanë aftësi më të mëdha eksploruese, janë më të përqendruar, mbajnë kontakt më shumë me objektet/lodrat dhe nuk shpërqendrohen lehtë nga stimujt mjedisor, janë këmbëngulës dhe aktiv gjatë lojës. Djemtë kanë më shumë iniciativë gjatë lojës, nuk paraqesin probleme emocional dhe përshtaten më lehtë, me çdo situatë të re të krijuar. Ky kërkim mund të pasurohet edhe me kërkime të tjera të cilat mund të konfirmojnë ose rrëzojnë hipotezën tuj.

Konkluzione

Marrëdhënia me nënën, e cila themelohet që në konceptimin e fëmijës është vendimtare për zhvillimin e fëmijës dhe perspektiven e tij në të ardhmen. Kjo marrëdhënie e quajtur atashim nënkupton përshtatje e mbështetje emocionale të nënës me fëmijën. Të pasurit e një marrëdhënie të shëndetshme me nënën, i jep më shumë aftësi dhe kompetenca të jetë një agjent aktiv në mjedisin që e rrethon. Atashimi i shëndetshëm me nënën është një faktor i rëndësishëm në formimin e fëmijës, për të qenë sa me social dhe eksplorues në sjelljet e tij. Nga studimi i kryer te fëmijët e moshës parashkolllore dolëm në konkluzionet

- ← mëposhtme:
 - ← Siguria dhe koha e dedikuar, cilësore dhe sasiore, që nëna investon tek fëmija i jep më shumë vetëbesim atij, duke i dhënë mundësinë të përjetojë me entuziazëm situatë të reja, ti pranojë dhe të përshtatet lehtësisht me to.
 - ← Forcimi i aftësisë për të thënë “unë dua”, “unë dëshiroj”, “mua nuk më pëlqen,” është tregues i qartë i një fëmije të shëndetshme që ka vetëbesim dhe vetëvlerësim të lartë.
 - ← Fëmijët që kanë marrëdhënie të varfra atashuese me nënën, nuk shprehin kuriozitet në njohjen dhe ndërveprimin me bashkëmoshatarët dhe shfaqin sjellje mosbesuese dhe të paqëndrueshme, duke shprehur zemërim në situatat specifike.
 - ← Në atashimin e shëndetshëm ndikon edhe gjendja emocionale e nënës, siguria për jetën, mbështetja shoqërore e ekonomike e saj.
 - ← Në sjelljet eksploruese ndikojnë edhe rolet gjinore të fëmijëve, duke sjellë tipare të ndryshme për rastet në studim, duke parë se kanë ndikim të veçantë në zhvillimin e sjelljeve eksploruese te fëmijët e moshës 5-6 vjeç.

Gjatë këtij studimi u konstatua se fëmijët kanë nevojë për procesin e atashimit të fëmijës nga nëna, apo nga një person tjetër kujdestar, për ta patur më të lehtë komunikimin me botën që i rrethon, për të qenë më eksplorues në sjelljet e tyre të përditshme. Problemet sociale e ekonomike apo psikologjike, që përjeton nëna, apo personi kujdestar i fëmijës, transmetohen emocionalisht te fëmija dhe ndikojnë negativisht në atashimin e shëndetshëm të fëmijës me nënën. Kjo situatë sjell probleme e vështirësi në zhvillimin psiko-social të fëmijës, duke u bërë pengesë për sjelljet eksploruese të fëmijës, me anë të të cilave njej e studion botën që e rrethon. Marrëdhënie me fëmijën mund t'i krijojnë atij një “bazë” me të cilën e ndihmon të eksplorojë mjedisin përreth. Siç e shpjegon Bowlby, në teorinë e tij të atashimit, në lidhje me marrëdhënien nënë-fëmijë, edhe në këtë rast nuk mund të ketë një eksplorim të vlefshëm nëse fëmija nuk ndihet i sigurt me njeriun që e mbështet. Fëmija ka nevojë për iniciativën duke thjeshtëzuar takimin mes aktivitetit të tij dhe qëllimit të rriturit; në këtë mënyrë shtohet mundësia e një

aleance të mirë me fëmijën. Nëse do të jetë ai që do të marrë iniciativën, do të kemi një mundësi më të madhe për arritjen e rezultateve pozitive, sepse do të jetë i interesuar të rrijë me ne. Kur ne t'i përgjigjemi ndërmarrjeve të tij do t'a ndihmojmë t'i zhvillohet sensi i sigurisë. Fëmija që mëson me ne është një qenie unike, që është në një moment vendimtar të zhvillimit të tij konjitiv, linguistik dhe afektiv. Momenti i tij i zhvillimit është i ndryshëm nga ai i të rriturit dhe është e nevojshme një formë përshtatjeje nga të dyja palët, për të pasur një komunikim efektiv. Duhet që i rrituri të shkëputet nga vizioni i tij adulto-centrik dhe të deportojë në botën e fëmijës. Për të bërë këtë mund të ndihmohemi nga vetë fëmija dhe nga ajo që njohim për të. Gjatë bisedës me fëmijën tuaj, duhet të jeni ju ai që përshtateni dhe të bini në nivelin e tij. Fëmijët e kanë të vështirë t'u përshtaten të rriturve dhe botës së tyre, prandaj shpesh e kanë ndjenjën e mospërshtatshmërisë. Kjo gjë u konstatua gjatë studimit në vendosjen e marrëdhënieve të para midis nesh, ndaj dhe kërkohet maturi dhe kujdes në vendosjen e miqësisë me ta, me qëllim që të jenë sa më aktiv në sjelljet e tyre.

Rekomandime

Duke parë nga afër problematikat e shfaqura në lidhje me atashimin e nënës me fëmijën dhe rolin e madh që luan kjo lidhje në ndërtimin e botës emocionale të fëmijës, në praktikimin e sjelljeve eksploruese, të cilat janë të nevojshme për zhvillimin dhe formimin e tij, dolëm në rekomandimet e mëposhtme:

- ← Atashimi i nënës me fëmijën duhet të kryhet në kushte të përshtatshme psiko-sociale nga nëna apo nga personi që kujdeset për fëmijën.
- ← Sensibilizimi i familjes me rëndësinë e procesit të atashimit të shëndetshëm të nënës me fëmijën.
- ← Nëna duhet të jetë e ndërgjegjësuar për rëndësinë që ka komunikimi i saj me fëmijën, i cili fillon që me konceptimin e tij.
- ← Të shmangen të gjitha ngarkesat emocionale negative të nënës gjatë komunikimit me fëmijën.
- ← Duhet t'i përkushtohet kohë e mjaftueshme sasiore e cilësore fëmijës. Figurat atashuese me fëmijën, që mund të jenë pjesëtarët e familjes, sidomos nëna, duhet të tregojnë dashuri, ngrohtësi e përkrahje për të. Gjatë kohës që rrinë me të duhet të jenë të përkushtuar ndaj dëshirave, pyetjeve apo vështrimeve të tyre.
- ← Kontakti fizik, sidomos me nënën duhet të jetë i pranishëm në jetën e fëmijës. Nëna duhet të tregojë dashuri me anë të përqafimeve, prekje, ledhatime, buzëqeshje, përkrahje e mbështetje me qëllim që fëmija të ndihet i sigurt.
- ← Të zhvillohen biseda të ndryshme me fëmijën rreth aktivitetit të tij ditor me shokët, në kopësht apo në mjedise të tjera. Gjatë bisedës të tregohet vëmendje, përkushtim e dashuri për fëmijën.
- ← .Bashkëveprimi me fëmijën në aktivitete të ndryshme, lojëra, vizita në vende interesante, aktivitete sportive, për të parë e zbuluar më mirë natyrën dhe problematikat e mundshme.
- ← Duhet të sillemi natyrshëm me fëmijën, gjatë procesit të komunikimit apo të çdo lloj marrëdhënie qoftë.
- ← Të përkrahim e inkurajojmë fëmijët në sjelljet e tyre eksploruese, pavarësisht rezultatit që arrin fëmija me veprimin e tij.
- ← Duhet të sigurojmë për fëmijët një ambient miqësor, dashamirës e inkurajues.
- ← Të mbështesim iniciativën e fëmijës, për të vetëvepruar dhe për të qenë me eksplorues në sjelljet e tyre.
- ← Sjelljet eksploruese, edukojnë dhe zhvillojnë njeriun e ardhshëm, kërkues e kurajoz, këmbëngulës e ambicioz, për të ecur përpara.
- ← Duhet të ndikojmë për shmangien e sjelljeve me prirje egocentrike të fëmijës, me qëllim që të jetë sa më social, e sa më bashkëpunues në marrëdhëniet e përditshme.

Bibliografia

- Betherton. I, The origin of attachment theory, *Developmental Psychology*, (1992), 28,759-772
- Cassidy. J & Shaver.P.R, *Handbook of attachment: theory, research and clinical applications*, 2008, kap. I
- Cassidy. J & Shaver.P.R, *Handbook of attachment: theory, research and clinical applications*, 2008, kap. 4, fq.78.
- Cassidy. J & Shaver.P.R, *Handbook of attachment: theory, research and clinical applications*, 2008, kap. 36.
- Instituti i Sociologjisë, Fletore Vlerësimi për fëmijët e moshës 5-6 vjeç.
- Keruti.K., LLeshi.M., Mato. E., Noti.K., Sina. E., (2009), Gati për në shkollë, fq. 67-88.
- McLean. M., & Wolery. M., (2004), Assessing infants and preschoolers with special needs, fq. 451, kap. 14, *Assessing play skills*.
- Plummer. D. M., (2008), *Anger Management Games for Children*, pg. 77-90.

KONCEPTI I PACËNUESHMËRISË DHE SJELLJET E RREZIKSHME PËR SHËNDETIN TEK ADOLESHENTËT SHQIPTARË

DEJLA HOXHA, BA

ERIKA MELONASHI, PHD

Shkolla Doktorale, Universiteti European i Tiranës

ABSTRAKT

Studimi aktual shqyrtoi marrëdhënien mes konceptit të pacenueshmërisë (dy konstruktet e saj: pacenueshmëria ndaj rrezikut dhe pacenueshmëria psikologjike) dhe sjelljeve të rrezikshme për shëndetin (konsumimi i alkoolit, duhanit, substancave narkotike; sjelljet seksuale së bashku me indikatorët përkatës). Qëllimi i studimit të kryer ishte të shqyrtonte mënyrën sesi këto dy variabla lidhen mes tyre në kontekstin shqiptar, duke u fokusuar në periudhën e adoleshencës. Në studim morën pjesë 140 pjesëmarrës të moshës nga 13 vjeç deri në 21 vjeç. Moshja mesatare e pjesëmarrësve ishte 18 vjeç. Në terma të përkatësisë gjinore 31.4% ishin meshkuj dhe 68.6% ishin femra. Instrumenti i përdorur për mbledhjen e të dhënave konsistonte në një pyetësor vetë-raportues të ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë përmbante pyetje të përshtatura nga pyetësori i UCLA, Chis 2009 Adolescent Questionnaire, të cilat shërbenin për matjen e sjelljeve të rrezikshme për shëndetin; ndërsa pjesa e dytë konsistonte në përdorimin e një shkalle me 20 pyetje, Adolescent Invulnerability Scale (AIS), e zhvilluar nga Lapsley & Duggan (2001) për matjen e dy konstrukteve të pacenueshmërisë (pacenueshmëria ndaj rrezikut dhe pacenueshmëria psikologjike). Rezultatet treguan lidhje mes pacenueshmërisë ndaj rrezikut dhe përdorimit të substancave narkotike ($r = .20, p < .05$), gjinisë së pjesëmarrësve ($r = .28, p < .05$), moshës së kryerjes së marrëdhënies së parë seksuale ($r = -.27, p < .05$), moshës së fillimit të konsumimit të alkoolit ($r = -.32, p < .05$) dhe duhanit ($r = -.42, p < .05$) si dhe sasisë së pijeve të konsumuara në një javë ($r = .38, p < .05$). Rezultatet gjithashtu treguan lidhje të pacenueshmërisë psikologjike me moshën e pjesëmarrësve ($r = -.22, p < .05$) dhe moshën e fillimit të konsumimit të duhanit ($r = -.39, p < .05$). Këto gjetje janë diskutuar në kontekstin e implikimeve praktike.

Fjalë kyç: koncepti i pacenueshmërisë, sjelljet e rrezikshme për shëndetin, adoleshenca, konteksti shqiptar

Hyrje

Adoleshenca përkufizohet si periudha e jetës që shtrihet në moshën 10-24 vjeç (Kipke, 1999:1), gjatë së cilës individët bëjnë kalime zhvillimore nga fëmijëria në moshë madhore. Adoleshenca karakterizohet nga ndryshime të dukshme fizike, emocionale dhe intelektuale si dhe ndryshime në role sociale, marrëdhënie dhe pritshmëri, ku të gjitha këto janë të rëndësishme për zhvillimin e individit dhe sigurojnë bazat për funksionimin e tij si një i rritur (AMCHP, 2005: 5). Adoleshentët përballen me një grup kompleks sfidash zhvillimi.

Ata përjetojnë ndryshime fizike, konjitive, sociale e emocionale teksa kërkojnë pavarësi më të madhe nga prindërit e tyre, pranim nga moshatarët dhe fillojnë të lundrojnë në role të reja sociale të ngjashme me të rriturit. Për shumicën e adoleshentëve këto ndryshime shoqërohen me negocimin e kërkesave dhe presioneve të reja e konfliktuale, eksplorimin e ideve të reja dhe sjelljeve të rrezikshme, angazhimin në detyra intelektuale më komplekse dhe formimin e identiteteve të dallueshme (Kipke, 1999: 7-8).

Koncepti i pacenueshmërisë

Në aspektin e studimeve mbi adoleshencën pacenueshmëria shihet kryesisht si ndjesia e të qenit të mbrojtur nga dëmtimi apo lëndimi. Adoleshenca shpesh përshkruhet si periudha në të cilën individët e shohin veten si të paprekshëm nga rreziku. Ndjenja e perceptuar e pacenueshmërisë nga adoleshentët lidhet me tendencën e tyre për ta parë veten si unikë (fabula personale) dhe ky këndvështrim i unikalitetit përfshin dhe besimin e të qenit unikalisht imunë ndaj pasojave që mund t'u ndodhin të tjerëve. Studimet (Millstein & Halpern-Felsher, 2002: 420) tregojnë se adoleshentët, në krahasim me të rriturit, i konsiderojnë më të pakta gjasat për të përjetuar pasoja negative nga vendimet që ata marrin (Levesque, 2011: 1489).

Dy teori pohojnë se pacenueshmëria është një tipar normativ i adoleshencës.

Teoria e Elkind (1967, cituar tek Lapsley & Hill, 2009: 2) e shikon pacenueshmërinë si një problem të zhvillimit konjitivku shihet se burimi i pacenueshmërisë është egocentrizmi që i takon kalimit në stadin e operacioneve formale. Elkind (1967, 1985, cituar tek Hill, Duggan & Lapsley, 2010: 2) shpjegon se adoleshentët arrijnë të përjetojnë një ndjesi "pathyeshmërie" si shoqëruese e egocentrizmit të lindur në adoleshencë. Kjo i predispozon ata të mendojnë se pasojat dëmtuese ka më shumë shanse t'u ndodhin të tjerëve sesa atyre vetë. Fabula personale është një tipar i adoleshencës i cili formëson vendim-marrjen (Hill et al, 2010:2-3).

Qasja tjetër zhvillimore i takon teorisë së zhvillimit të egos sipas Blos (1962, cituar tek Hill et al. 2010:3). Sipas kësaj teorie, pacenueshmëria është një produkt i procesit të ndarjes-individualizimit dhe nga kjo rrjedh se ajo nuk është një problem i zhvillimit konjitiv, por i zhvillimit të egos. Sipas Blos (1962, cituar tek Hill et al. 2010:3), pacenueshmëria është një mbrojtje narcistike kundrejt trishtimit. Kjo i jep adoleshentit një ndjenjë pathyeshmërie dhe fuqie false e cila nga ana e saj dëmton gjykimin në situata kritike duke rezultuar në situata negative.

Të dy autorët (Elkind dhe Blos) e shohin pacenueshmërinë si diçka që i ekspozon adoleshentët ndaj rreziqeve të mëdha pasi dëmton vendim-marrjen (Hill et al., 2010:3).

Por pacenueshmëria nuk qëndron vetëm si faktor rreziku në adoleshencë. Një qasje miqësore ndaj pacenueshmërisë vjen nga studime të tilla teorike si (Lapsley & Murphy, 1985, cituar tek Lapsley & Hill, 2009:1) dhe empirike (Lapsley et al., 1986 cituar tek Lapsley & Hill, 2009: 1). Kjo qasje e sheh pacenueshmërinë jo si një gabim diferencializmi, por si një përgjigje adaptive narcistike ndaj sfidës zhvillimore të ndarjes-individualizimit.

P.sh: Eksplorimi i identitetit, krijimi i një miqësie të re, mësimi i një aftësie, aplikimi për punë apo universitet, të kërkuarit e takimeve romantike etj, të gjitha kërkojnë marrjen përsipër të një risku kur dihet se dështimi gjithashtu qëndron si opsion. Në këtë pikë imazhi për veten rrezikohet nga këto zgjedhje, por pa rrezikim nuk do të kryheshin detyrat e këtij stadi zhvillimor për të kaluar më pas tek tjetri. Prandaj jo të gjithë risqet e marra përsipër janë keq-adaptivë. Në shumë rrethana, adoleshenti i cili ka ndjenjën e pacenueshmërisë mund të jetë shumë më mirë i pajisur për t'u përballur me sfidat normative të moshës (Lapsley & Hill 2009: 2).

Duke u bazuar në pikëpamje të tilla teorike, Lapsley & Duggan (2001:2) e kanë parë pacenueshmërinë si të përbërë nga dy konstrukte: pacenueshmëria ndaj rrezikut dhe pacenueshmëria psikologjike.

Pacenueshmëria ndaj rrezikut

Konstrukt i parë është *Pacenueshmëria ndaj Rrezikut* (PR). Ky konstrukt përfaqëson të ndjerit të pacenueshëm ndaj rreziqeve të jashtme dhe është më i lidhur me sjelljet e rrezikshme. Pikë të larta në këtë nënshkallë sipas Adolescent Invulnerability Scale (AIS) asociohen me konsumimin e alkoolit, drogërave e duhanit si dhe me një mundësi të ulët të mbrojtjes së vetes ndaj rreziqeve të HIV (Ravert et al., 2009). Lapsley & Hill (2009) mbështetën faktin se PR parashikonte delinkuencë më të madhe dhe përdorim më të madh substancash.

Pacenueshmëria Psikologjike

Pacenueshmëria Psikologjike (PP) është konstrukt i dytë i pacenueshmërisë. Ajo përfaqëson një pacenueshmëri ndaj ankthit psikologjik dhe çon drejt një profili psikologjik më adaptues. Ajo gjithashtu është një kundër-tregues, pra ka marrëdhënie

negative me shenjat depresive tek adoleshentët. Kjo mbështet pretendimet se pacënueshmëria mund të jetë e dobishme pasi nxit përballim dhe rregullim pozitiv të adoleshentit gjatë lindjes dhe formimit të egos e identitetit. (Hill et al., 2010: 3-4).

Studimi empirik i Hill et al. (2010) duket se ka gjetur prova të mjaftueshme të cilat lidhin PR me sjelljet delinkuente dhe përdorimin e substancave si dhe PP me përballimin dhe kontrollin e situatave.

Sjelljet e rrezikshme për shëndetin

Përdorimi i substancave

a. Përdorimi i duhanit

Një raport i WHO (2013) na ofron të dhëna mbi përqindjen e duhanpirësve të moshës 13-15 vjeç në Shqipëri. Përkatësisht 17.6 % e meshkujve dhe 6.7% e femrave të kësaj moshe raportohet të konsumojnë duhan. Gjithashtu 1/3 e të rinjve që kanë provuar duhanin, e kanë provuar atë para moshës 10 vjeç. Përsa i përket të gjithë popullsisë, raportohet se rreth 40% e shqiptarëve konsumojnë duhan.

b. Përdorimi i alkoolit

Në një raport të European School Survey Project on Alcohol and Other Drugs (ESPAD) (2011), 32% e studentëve shqiptarë raportuan se kishin konsumuar alkool në 30 ditët e fundit ndërsa 21% deklaruan se kishin kryer konsumim të rëndë episodik gjatë 30 ditëve të fundit. Rreth 40% e meshkujve të rinj raportojnë se konsumojnë të paktën një pije në javë (USAID, 2006: 49).

c. Përdorimi i substancave narkotike

Sipas një studimi të ISHP-së në 2009 (cituar tek European Monitoring Centre for Drugs and Drug Addiction (EMCDDA), 2009), 7.4% e të intervistuarve nga mosha 15-18 vjeç kishin eksperimentuar me kanabisin, 4.2% me ekstazi, 1,2% me heroinë dhe 3.2% me kokainë. Kjo matje u bë në një prevalencë jetësore.

Sjelljet e rrezikshme seksuale

Në sjelljet e rrezikshme seksuale do të përfshihet kryerja e marrëdhënieve seksuale në moshë të vogël, mos-përdorimi mjeteve mbrojtëse, numri i partnerëve seksualë etj.

Studimi i USAID në 2006 raporton shifra përse i përket sjelljeve seksuale në Shqipëri. Në një kampionim ku mosha mesatare ishte 29 vjeç, u raportua se 93 % e meshkujve dhe 82 % e femrave kishin kryer marrëdhënie seksuale. Mosha mesatare e kryerjes së marrëdhënies së parë për meshkujt ishte 19 vjeç ndërsa për femrat 20.5 vjeç. 47.7% e pjesëmarrësve kanë kryer marrëdhënie në moshat 15-18 vjeç. Përsa i përket përdorimit të kondomit, 35.6% raportonin se e përdornin . Përsa i përket partnerëve seksualë në 12 muajt e fundit, 59% e meshkujve dhe 81% e femrave raportonin marrëdhënie me një partner afatgjatë. (USAID, 2006: 50-52).

Statistikat për Shqipërinë në vitet e fundit nuk janë të shumta e për këtë arsye do t'i referohemi një studimi në formë disertacioni. Nga të dhënat e 2000 studentëve të përfshirë në studim (Mërkuri, 2013) u pa se 61.7% e tyre kishin kryer marrëdhënie seksuale, përkatësisht 85% e meshkujve dhe 44% e femrave, pra thuajse dyfish më e madhe për meshkujt. Mosha mesatare e kryerjes së marrëdhënies së parë është 17 vjeç për meshkujt dhe 19 vjeç për femrat. Përsa i përket numrit të partnerëve, të intervistuarit kanë raportuar mesatarisht 2.2 partnerë. Vëzhgimi ndaj përdorimit të kondomit tregoi se 82.2% e studentëve përdornin kondom në marrëdhëniet e tyre seksuale.

Lidhja e konceptit të pacënueshmërisë dhe sjelljeve të rrezikshme

Koncepti i pacënueshmërisë interpretohet si ndjesia e të qenit i mbrojtur nga dëmtimi dhe lëndimi. Siç u shpjegua më lart, një ndjesi e tillë shpesh i nxit adoleshentët të marrin përsipër kryerjen e sjelljeve të rrezikshme pa marrë parasysh pasojat. Ndër këto sjellje të rrezikshme zënë vend sjelljet e rrezikshme ndaj shëndetit. Studime të huaja të ndryshme hedhin dritë mbi lidhjen mes sjelljeve të rrezikshme dhe konceptit të pacënueshmërisë. Studimi i Lapsley, Aalsma & Halpern-Felsher (2005) doli në përfundimin se pacënueshmëria ishte një parashikues domethënës i një varieteti sjelljesh të rrezikshme duke përfshirë përdorimin e duhanit, alkoolit dhe substancave të tjera të kontrolluara. Të njëjtat rezultate u arritën dhe në studimin e Aalsma et al. (2006) duke u fokusuar kryesisht tek konstrukti i PR si parashikues kryesor i këtyre sjelljeve. Një studim i ngjashëm i vitit 2010 (Hill et al.) mbi pacënueshmërinë dhe sjelljet e rrezikshme në adoleshencë gjithashtu konkludoi se PR parashikonte sipërmarrje më të mëdha të risqeve duke u fokusuar në matjet e përdorimit jetësor të substancave narkotike dhe frekuencës së përdorimit të tyre.

← nga ana tjetër mbështetet gjithashtu nga studime të shumta të cilat shkojnë në një linjë me njëra-tjetrën. Në Studimin e Lapsley et al. (2005), u vu re se pacënueshmëria gjithashtu parashikonte, edhe pse më dobët, disa tipare të shëndetit mendor pozitiv duke përfshirë respektin ndaj vetes dhe aftësinë përballuese. Kjo lloj pacënueshmërie e cila kishte karakteristika parashikuese mbi shëndetin mendor u cilësua si pacënueshmëria psikologjike. Aalsma, Lapsley & Flannery (2006) gjithashtu ofroi të dhëna nga studimi i saj duke treguar se pacënueshmëria lidhej pozitivisht me narcizizmin dhe respektin ndaj vetes.

Qëllimi dhe Objektivat

Studimi i kryer është i një trajte deduktive, teori-testuese. Ai u bazua mbi analizë të dhënash sasiore të cilat u fokusuan në testimin e hipotezave. Studimi u krye mbi bazën e të dhënave parësore të mbledhura nëpërmjet pyetësorëve si dhe shqyrtimit të literaturës përkatëse lidhur me temën.

Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë mënyrën sesi koncepti i pacenueshmërisë lidhet me sjelljet e rrezikshme për shëndetin në kontekstin shqiptar, duke u fokusuar në periudhën e adoleshencës. Ndjekja e këtij qëllimi bëhet e mundur me anë të përcaktimit të disa objektiveve. **Objektivat** e këtij studimi janë shqyrtimi i adoleshencës si stad zhvillimor duke patur parasysh pasqyrimin teorik të *konceptit të pacenueshmërisë* dhe *sjelljeve të rrezikshme për shëndetin*. Shqyrtimi i tyre në kontekstin e shqiptar do të jetë hapi i radhës. Së fundmi, trajtimi dhe analizimi i *lidhjes* mes konceptit të pacenueshmërisë dhe sjelljeve të rrezikshme do të jetë hapi përfundimtar që do çojë drejt realizimit të qëllimit të studimit.

Pyetja kërkimore, Hipotezat dhe Metodologjia e Punimit

Pyetja kërkimore e cila ndjek linjën e qëllimit të studimit është: “A ka një marrëdhënie midis konceptit të pacenueshmërisë (dy konstrukteve të tij, PR dhe PP) dhe sjelljeve të rrezikshme për shëndetin?”

Hipoteza kryesore, është: “Ekziston një lidhje midis konceptit të pacenueshmërisë dhe sjelljeve të rrezikshme për shëndetin”. Pra *variabli i pavarur* është pacenueshmëria me dy dimensionet e saj PR dhe PP. *Variabilet e varur* janë sjelljet e rrezikshme për shëndetin të cilat përfshijnë konsumimin e alkoolit, duhanit, substancave narkotike dhe sjelljet seksuale. Indikatorët e përdorimit të substancave si konsumimi ose jo i alkoolit, duhanit dhe substancave narkotike si dhe mosha e fillimit të këtyre sjelljeve paraqiten si variabla të varur në raport me konceptin e pacenueshmërisë dhe dy konstrukteve të saj, PR dhe PP. Indikatorët e sjelljes seksuale si mosha e aktivitetit të parë seksual, përdorimi i kondomit apo numri i partnerëve gjithashtu paraqiten si variabla të varur përkundrejt konceptit të pacenueshmërisë.

Pjesëmarrësit

149 adoleshentë të moshës nga 13 deri në 21 vjeç morën pjesë në këtë studim. U synua ky hark moshor pasi harku 10 - 25 vjeç (Kipke, 1999: 1) ishte tepër i zgjeruar për këtë lloj studimi. Mosha mesatare e pjesëmarrësve ishte 18 vjeç ndërsa mediana 17 vjeç. (17 vjeç për femrat dhe 18 për meshkujt). Në terma të përkatësisë gjinore, 44 pjesëmarrës ishin meshkuj (31.4%) dhe 96 pjesëmarrëse ishin femra (68.6 %). Kampionimi i pjesëmarrësve ishte një ndërthurje mes kampionimit të konvencionalit dhe kampionimit referencial. Ndërthurja zvogëlon disi komponentin e konvencionalit pasi pjesëmarrësit jo domosdoshmërisht kanë qenë lehtësisht të arritshëm. Komponenti referencial rrit diversitetin e moshës dhe grupeve shoqërore duke e bërë kampionimin më pak konvencional dhe rritur besueshmërinë e studimit. Kampionimi i konvencionalit dhe referencial u panë si të dobishëm për këtë studim pasi ofronin mundësinë e background-eve të ndryshme të pjesëmarrësve. Në këtë mënyrë u shmang përzgjedhja e një shkolle specifike në Tiranë për të shpërndarë pyetësorin, pasi faktorë të tillë si vendndodhja e shkollës (qendër/periferi; e pasur/e varfër) apo lloji i shkollës (private/publike; profesionale/e përgjithshme) do të kishin ndikim në rezultate e do të formonin pritshmëri parajgjyqese ndaj përgjigjeve të pjesëmarrësve. Pas një periudhe dy-javore, të dhënat u mbledhën dhe u sistemuan. Si pasojë e plotësimit të paplotë, 9 pyetësorë nuk u përdorën në analizën finale – duke rezultuar në një numër përfundimtar N prej 140 pjesëmarrësish.

Procedura

Pyetësori u zhvillua online duke përdorur një platformë interaktive të quajtur Google Docs. U preferua plotësimi online për disa arsye.

Së pari, ofron lehtësi aksesit dhe shpërndarje të pyetësorit duke kursyer kohë dhe financa.

Së dyti, anonimatit i ofruar online minimizon ndrojtjen për t’ju përgjigjur pyetjeve personale të lidhura me sjelljet seksuale dhe përdorimin e substancave narkotike.

Së treti, nxitja e sjelljeve të gjelbra duke shfrytëzuar benefitet teknologjike për të kursyer letrën për 140 pyetësorë.

Pyetësori u shpërnda nëpërmjet rrjeteve sociale dhe e-mail-it. Në mungesë të një versioni të standardizuar në shqip, pyetësori u përkthye nga studiuesit. Fillimisht një pyetësor pilot iu shpërnda katër adoleshentëve për të testuar kuptueshmërinë. Pas feedback-ut nga adoleshentët, pyetjet e paqarta u rishikuan e riformuluan. Në hyrje të pyetësorit u vendos deklarata mbi anonimitetin dhe qëllimi i mbledhjes së të dhënave, ndërsa në secilin nga seksionet e pyetësorit u vendosën sqarimet përkatëse për plotësimin e pyetjeve. Mbledhja e të dhënave u krye në një hark kohor prej dy javësh.

Materialet

Instrumenti i përdorur për këtë studim ishte pyetësor vetë-raportues. Pyetësori i përdorur përbëhej nga dy pjesë:

Pjesa e parë synonte të mbledhte të dhëna demografike, konkretisht mosha dhe gjinia si dhe të dhëna mbi sjelljet e rrezikshme.

Pyetjet mbi sjelljet e rrezikshme u përshtatën nga Chis 2009 Adolescent Questionnaire (UCLA CHPR, 2009-2010: 17,22) por u modifikuan sipas qëllimeve të këtij studimi. Katër pyetje lidheshin me sjelljet seksuale si 1-“Keni kryer ndonjëherë marrëdhënie seksuale?”, 2-“Moshë e kryerjes?”, 3-“Numri i partnerëve seksualë në 12 muajt e fundit?” dhe 4-“A përdorni mjete mbrojtëse?” Pyetja 1 dhe 4 u matën me një shkallë dikotomike të polarizuar në “Po” dhe “Jo”.

Grupi tjetër i pyetjeve (shtatë) të pjesës së parë të pyetësorit lidheshin me përdorimin e substancave. Pyetjet konsistonin në konsumin apo jo të duhanit, alkoolit dhe substancave narkotike ku përgjigjet përsëri mateshin me një shkallë dikotomike polare “Po/Jo”. Moshë e fillimit të konsumimit kërkohet për duhanin dhe alkoolin. Indikatorë të tjerë të matur ishin dhe sasia e alkoolit të konsumuar në një javë (0, 1-2, 3-4, 4-7, 7+) dhe lloji i substancave narkotike të konsumuara.

Pjesa e dytë e pyetësorit synonte të maste *konstruktin e pacënueshmërisë*.

Për qëllimin e matjes së pacënueshmërisë u përdor një shkallë me 20 pyetje e zhvilluar nga Daniel K. Lapsley (2001), Adolescent Invulnerability Scale (AIS). Shkalla kërkonte që pjesëmarrësit të vlerësonin pyetjet në një Shkallë Likert me 5 opsione ku Totalisht Jo Dakord (1), Jo Dakord (2), Neutral/Asnjës (3), Dakord (4) dhe Shumë Dakord (5). Më specifikisht dymbëdhjetë pyetje të pyetësorit janë të lidhura me pacënueshmërinë ndaj rrezikut si p.sh “Me shumë gjasa unë mund të konsumoj alkool dhe të ngas makinën pa bërë aksident.” ndërsa tetë pyetje janë të lidhura me pacënueshmërinë psikologjike si p.sh “Është thjeshtë e pamundur për njerëzit që të më lëndojnë mua ndjenjat”. Pyetje të lidhura me pacënueshmërinë ndaj rrezikut kishin të bënin me rregullat e sigurisë, të ngarit e makinës me shpejtësi, perceptimin e mundësisë së të prekurit nga një sëmundje etj. Pyetje të lidhura me pacënueshmërinë psikologjike kishin të bënin me shkallën e lëndimit të ndjenjave, opinionet e të tjerëve, fjalët e njerëzve etj. Të dy nënshkallët treguan konsistencë të brendshme të mirë ku nënshkalla e matjes së pacënueshmërisë ndaj rrezikut (12 pyetje) kishte një $\alpha = .72$ dhe nënshkalla e matjes së pacënueshmërisë psikologjike (8 pyetje) kishte një $\alpha = .75$.


Rezultatet

Rezultatet përshkruese

Sjellja seksuale


Rezultatet treguan se 49.3% e pjesëmarrësve nuk janë aktiv seksualisht ndërsa 50.7% janë aktivë seksualisht.

GRAFIKU 1: NDARJA E PJESËMARRËSVE SIPAS TË QENURIT OSE JO SEKSUALISHT AKTIV



Duke iu referuar “Grafikut 2” shohim ndryshimet e eksperiencës së parë seksuale sipas moshës. Vërejmë se moshë mesatare e eksperiencës së parë seksuale varion mes 16 vjeç dhe 18 vjeç, ku 16 vjeç është moshë më e hasur.

GRAFIKU 2: MOSHA E KRYERJES SË MARRËDHËNIES SË PARË SEKSUALE



Duhani


Nga të dhënat e tabelës së mëposhtme (Tabela 1), përsa i përket konsumit të duhanit, mund të shohim se rreth 2/3 e pjesëmarrësve nuk janë konsumatorë të duhanit dhe vetëm 31.4 % kanë raportuar përdorim të tij

TABELA 1: PËRFAQËSIMI I KONSUMIMIT TË DUHANIT TEK PJESËMARRËSIT

Konsumi	Frekuenca	Përqindja
Jo	96	68.6%
Po	44	31.4%
Totali	140	100%

Grafiku 3 na ofron të dhëna në lidhje me moshën e fillimit të konsumimit të duhanit. Siç shohim, mosha më e përhapur e fillimit të konsumimit është mosha 15 vjeç (33.3%) e ndjekur nga mosha 14 vjeç (17.8%). Sipas raportit të vitit 2008-2009 (INSTAT, IShP) mosha mediane e fillimit të konsumimit të duhanit për femrat e moshës 20-24 vjeç në Shqipëri është 18.1 vjeç ndërsa për meshkujt e së njëjtës grupmoshë, mediana është 18.2 vjeç. Mosha mediane e pjesëmarrësve femra në studimin tonë është 17 vjeç ndërsa ajo e meshkujve 18 vjeç. Siç mund ta vëzhgojmë, me kalimin e viteve mosha e fillimit të konsumimit të duhanit vjen duke u ulur.

GRAFIKU 3: SHQYRTIMI I MOSHËS SË FILLIMIT TË KONSUMIT TË DUHANIT



Alkooli

Nga të dhënat e Tabelës 2 kuptojmë se 20.7% e pjesëmarrësve në studim nuk konsumojnë alkool ndërsa pjesa tjetër (79.3%) janë konsumatorë të tij. Përgjigjet pozitive ndaj konsumit të alkoolit nuk duhet të interpretohen si indikatorë të problemeve me alkoolin pasi në rrethin e atyre që kanë pranuar se konsumojnë alkool përfshihen edhe ata të cilët e konsumojnë atë “rrallë” apo “ndonjëherë”. Pra përqindja i takon prevalencës jetësore të konsumimit të alkoolit.

TABELA 2: SHQYRTIMI I KONSUMIMIT TË ALKOOLIT

Konsumi	Frekuenca	Përqindja
Jo	29	20.7%
Po	111	79.3%
Total	140	100%

Sipas Grafikut 4 që shohim më poshtë, moshë mesatare e fillimit të konsumimit të alkoolit është moshë 15 vjeç (25,9%) dhe 16 vjeç (22.2%). Kjo është thuajse e njëjta moshë e raportuar dhe për fillimin e konsumit të duhanit (14-15 vjeç). Nga çfarë shihet, mund të hamendësojmë se fillimi i konsumimit të njëjës substancë do të shoqërohet dhe me fillimin e konsumimit të tjetrës.

GRAFIKU 4: SHQYRTIMI I MOSHËS SË FILLIMIT TË KONSUMIT TË ALKOOLIT




Tabela 3 na jep informacion mbi numrin e pijeve të konsumuara gjatë një jave të zakonshme. Siç shihet, përqindja më e madhe (50.4%) i takon sasisë 1-2 pije një javë. Duke ju referuar Tabelës shohim se kemi dhe një përqindje (14.5%) pjesëmarrësish të cilët konsumojnë 0 pije në javë.

TABELA 3: SASIA E PIJEVE TË KONSUMUARA NË NJË JAVË

Numri i pijeve/javë	Frekuenca (nr. i personave)	Përqindja
0 pije/javë	16	14.5%
1-2 pije/javë	56	50.4%
3-4 pije/javë	25	22.5%
4-7 pije/javë	7	6.3%
7+ pije/javë	7	6.3%
Totali	111	100%

Substancat narkotike

Tabela 4 ofron të dhëna mbi përdorimin ose jo të substancave narkotike. Shohim se 20.7% e pjesëmarrësve kanë pranuar përdorimin e substancave narkotike (me shpeshësi konsumimi të ndryshme) ku përqindja më e madhe (82 %) konsumonin marijuanë.

TABELA 4: RAPORTIMI I KONSUMIMIT TË SUBSTANCAVE NARKOTIKE

Konsumimi	Frekuenca	Përqindjet
Po	29	20.7%
Jo	111	79.3%

Rezultate analitike

Tabela 5 tregon korrelacionet midis variabileve të pavarur (PR dhe PP) dhe variabileve të varur siç janë indikatorët e sjelljeve të rrezikshme për shëndetin. Indikatorët e sjelljeve të rrezikshme (variabilet e varur) që u morën parasysh për analizën janë 12 përkundrejt 2 variabileve të varur. Sipas tabelës së korrelacionit shohim se jo të gjithë sjelljet e rrezikshme për shëndetin kanë lidhje me konstruktet e pacenueshmërisë. Diskutimi i mëposhtëm do të bëhet në funksion të dy variabileve të pavarur PR e PP dhe korrelacioneve stilistikisht të rëndësishme.

TABELA 5 –KORRELACIONET

		Pacn. ndaj rrezikut	Pacn. psikologjike	Përdorimi i mjeteve mbrojtëse	Konsumimi i duhanit	Konsumimi i alkoolit	Përdorimi i subs. Narkotike	Mosha	Gjinia	Aktivose jo seksualisht	Mosha e marrdh. se pare seksuale	Partnerseksuale ne 12 muajt e fundit	Mosha e fillimitkons.teduhanit	Mosha e fillimitkons.tealkoolit	Sasia e pijevekons. ne njëjtave
Pacn. ndaj Rrezikut	Korrelacioni Pearson	1	.358**	-.197	.035	-.032	.201*	-.097	.279**	.154	-.269*	.228	-.424**	-.323**	.379**
Pacn. Psikologjike	Korrelacioni Pearson	.358**	1	-.134	-.060	-.103	-.022	-.220**	.030	-.077	-.215	.158	-.395**	-.146	.133

** Korrelacioni është i rëndësishëm në nivelin 0.01 (2-tailed).

* Korrelacioni është i rëndësishëm në nivelin 0.05 (2-tailed).

a. Nuk mund të kompjuterizohet sepse të paktën një prej variabileve është konstante

Pacnueshmëria ndaj Rrezikut

Sipas Tabelës 5 shikojmë se PR ka lidhje korreluese pozitive dhe negative me disa prej indikatorëve të sjelljeve të rrezikshme. a. PR dhe përdorimi i substancave narkotike

Ka një korrelacion pozitiv mes përdorimit të substancave narkotike dhe PR ($r = .20$ dhe $p < .05$). Nga drejtimi pozitiv i korrelacionit kuptojmë se ndjesia e pacenueshmërisë ndaj rrezikut është më e madhe tek personat të cilët konsumojnë substanca narkotike.

b. PR dhe gjinia

Një lidhje statistikisht e rëndësishme vendoset midis PR dhe gjinisë. Sipas kodimit përkatës gjatë analizës ku Femrat u koduan me (0) dhe Meshkujt me (1), mund të interpretojmë se korrelacioni pozitiv nënkupton një ndjesi më të madhe PR nga meshkujt sesa nga femrat. ($r = .28$ dhe $p < .05$)

c. PR dhe mosha e kryerjes së marrëdhënies së parë seksuale

Një korrelacion negativ u vëzhgua mes PR dhe moshës së kryerjes së marrëdhënies së parë seksuale ($r = -.27$ dhe $p < .05$). Ky drejtim negativ i korrelacionit sugjeron se sa më e ulët të jetë mosha e kryerjes së marrëdhënies së parë seksuale, aq më e lartë do të jetë ndjesia e PR.

d. PR dhe mosha e fillimit të konsumimit të alkoolit dhe duhanit

Lidhja e PR me moshën e fillimit të konsumimit të alkoolit karakterizohet nga $r = -.32$ dhe $p < .05$ ndërsa lidhja me moshën e fillimit të konsumimit të duhanit karakterizohet nga $r = -.42$ dhe $p < .05$. Të dyja lidhjet karakterizohen nga një

drejtim negativ çka do të thotë se sa më e vogël moshë e fillimit të konsumimit të alkoolit dhe duhanit, aq më e madhe ndjesia e PR. Korrelacioni mes PR dhe moshës së fillimit të konsumimit të duhanit duket të jetë dhe korrelacioni më i lartë mes PR dhe variabileve të lidhura me sjelljet e rrezikshme për shëndetin.

e. PR dhe sasia e pijeve të konsumuara në një javë

Korrelacioni midis këtyre dy variabileve është statistikisht i rëndësishëm dhe ka drejtim pozitiv ku $r = .38$ ku $p < .05$.

Mund të interpretojmë se sa më i lartë numri i pijeve të konsumuara në javë, aq më e lartë PR

Pacënueshmëria psikologjike

← krijon korrelacione statistikisht të rëndësishme vetëm me dy variabile të cilat do të përmenden më poshtë. a. PP dhe moshë

Një korrelacion negativ statistikisht i rëndësishëm ekziston mes PP dhe moshës ($r = -.22$ dhe $p < .05$). Një lidhje e tillë sugjeron se sa më e vogël moshë, aq më e madhe PP dhe sa më e madhe moshë, aq më e vogël PP.

b. PP dhe moshë e fillimit të konsumimit të duhanit

Edhe me variabilin e moshës së fillimit të konsumimit të duhanit, PP lidhet negativisht ($r = -.39$ dhe $p < .05$). Pra sa më e vogël moshë e fillimit të konsumimit të duhanit, aq më e lartë PP apo sa më e madhe moshë e fillimit të konsumimit të duhanit, aq më e ulët PP.

Diskutim

Qëllimi i këtij studimi ishte të shikonte marrëdhënien mes sjelljeve të rrezikshme për shëndetin dhe konceptit të pacënueshmërisë tek adoleshentët në kontekstin shqiptar. Ndër faktorët të cilët u përfshinë në analizë përveç indikatorëve të sjelljeve të rrezikshme dhe pacënueshmërisë ishin dhe variabilet moshë dhe gjini. Rezultatet e këtij studimi shkuan në linjë me disa nga studimet e huaja dhe ranë në kundërshti me disa të tjera. Mungesa e studimeve të tilla në Shqipëri e bën të pamundur krahasimin kontekstual të tyre.

Ky studim si fillim kërkoi mbledhjen e të dhënave mbi sjelljet e rrezikshme ndaj shëndetit tek adoleshentët shqiptarë (me anë të pjesës së parë të pyetësorit të përdorur) dhe nivelin e shkallës së tyre të pacënueshmërisë (të matur me pjesën e dytë të pyetësorit AIS). Krahasimi i të dhënave përshkruese me studimet e fushës treguan se sjelljet e lidhura me substancat kanë ndryshuar nga viti në vit në Shqipëri duke ndjekur një farë trendi. Siç shihet nga tabela e mëposhtme, me rritjen e moshës rritet dhe përqindja e konsumatorëve të duhanit. Moshë e fillimit të konsumimit të duhanit gjithashtu ndjek një trend zbritës ku duke krahasuar moshën e fillimit të konsumimit për grupmosha të ndryshme, shohim se sipas ISHP (Gazeta Shqip, 2013) grupmosha 20-24 vjeç kanë pasur një moshë mediane fillimi 18 vjeç, ndërsa për pjesëmarrësit e studimit tonë (mosha mesatare 18 vjeç), moshë e fillimit të konsumimit të duhanit ka qenë 14-15 vjeç.

TABELA 6: KRAHASIMI I TË DHËNAVE TË TRE STUDIMEVE MBI DUHANIN

Studimi	WHO	Studimi ynë	ISHP
Moshë	13-15 vjeçarë	Moshë mesatare 18 vjeç	Moshë mesatare e Pop. Shqiptare 35.3 vjeç
Përqindja e konsumatorëve	11.5%	31%	40%

Përsa i përket sjelljeve ndaj alkoolit, Tabela 7 e cila paraqitet më poshtë bën një krahasim mes të dhënave të tre studimeve të ndryshme. Sipas raportit të USAID (2006) rreth 27.6% e popullsisë (29.3% e meshkujve dhe 17% e femrave) (mosha mesatare 29 vjeç) konsumojnë alkool të paktën një herë në javë. Rreth 7.6% e pjesëmarrësve raportohet se konsumonin alkool çdo ditë sipas këtij raporti. Duke patur parasysh se moshë e pjesëmarrësve në këtë studim të USAID është 29 vjeç, kuptojmë se përqindja e konsumimit tek adoleshentët shqiptarë është në mënyrë të rëndësishme më e lartë se ajo tek të rinjtë (58.9% në krahasim me 27.6%). Sipas një raporti të ISHP (2013.b: 36) rreth 23 % e 15-vjeçarëve dhe rreth 18% e 13-vjeçarëve në Shqipëri konsumojnë 1-2 pije alkoolike në javë. Përsa i përket kategorisë “7+ pije/javë”, 15-vjeçarët konsumatorë ishin rreth 0.8%. Në moshën 18 vjeçare (mosha mesatare e pjesëmarrësve të studimit tonë) përqindja e atyre që konsumojnë më shumë se 7 pije në javë është në nivelin në 6.3%.

Këto shifra na lejojnë të interpretojmë se në periudhën e adoleshencës rritja e moshës shoqërohet si me rritjen e numrit të konsumatorëve, ashtu dhe me rritjen e sasisë së alkoolit të konsumuar. Rritja (e moshës) pas periudhës së adoleshencës nga

ana tjetër shoqërohet me uljen e përqindjes së personave që konsumojnë pije alkoolike një herë në javë ndërkohë që përqindja e personave të cilët konsumonin më shumë se 7 pije në javë mbetet thuajse e njëjtë si në adoleshencë ashtu edhe në moshën e rritur. Sipas këtyre treguesve mund të interpretojmë se personat të cilët kanë një konsumim problematik të alkoolit që në adoleshencë, e ruajnë këtë ritëm edhe në moshën e rritur. Ndërkohë përqindja e konsumatorëve të moderuar ulet me rritjen e moshës. Këto të dhëna mbështeten nga studimi i McCarty et al. (2004)

TABELA 7: KRAHASIMI I TË DHËNAVE TË TRE STUDIMEVE MBI ALKOOLIN

Numri i pijeve	15-vjeçarë	18-vjeçarë	29-vjeçarë
1-2 pije/javë	23%	50.4%	27.6%
7+ pije/javë	0.8%	6.3%	7.6%

Një vështrim krahasues mbi studimet e përmendura më lart (shqyrtimi i literaturës) në lidhje me sjelljet e rrezikshme seksuale, na ofron disa të dhëna interesante për të kuptuar zhvillimin e trendeve në Shqipëri. Nga vënia përballë e studimit të USAID (2006) dhe Mërkuri (2013) mund të shohim se në këtë periudhë 7 (shtatë) vjeçare statistikisht kanë ndryshuar. Aktiviteti seksual i 29 vjeçarëve (mosha mesatare) të vitit 2006 (87.5%) ndryshon me 26.5% me aktivitetin seksual të 20 vjeçarëve në vitin 2013 (61%).

Duke interpretuar shifrat e shtruara më poshtë (Tabela 8) mund të arrijmë në konkluzionin se mosha e fillimit të aktivitetit seksual duket se po zvogëlohet me kalimin e viteve. Nga viti 2006 deri në 2011 mosha e fillimit të aktivitetit seksual është ulur me rreth dy vite për secilën gjini. Përkatesisht nga 19 vjeç në 17 vjeç për meshkujt dhe nga 20.5 vjeç në 19 vjeç për femrat. Një tjetër studim (Subashi, 2014) i cili ka mbledhur të dhëna për grupmoshën 14-19 vjeç ofron një moshë akoma më të vogël të fillimit të aktivitetit seksual ku për meshkujt mendohet të jetë mosha 14-15 vjeç, ndërsa për femrat 15-16 vjeç. Ndër arsyt kryesore të përfshirjes në aktivitet seksual, pjesëmarrësit e studimit (Subashi, 2014) kanë përmendur: tërheqjen, përfitimet materiale e monetare, presionin shoqëror si dhe faktin se përfshirja në aktivitet seksual është një mënyrë e të sjellurit si i rritur.

TABELA 8: KRAHASIMI TË DHËNA VETË TRE STUDIMEVE MBI SJELLJET SEKSUALE

Viti	2006	2011	2014
Mosha mesatare	29 vjeç	20 vjeç	14-19 vjeç
Mosha e marrdh. së I-rë seksuale	M – 19 vjeç F – 20 vjeç	M – 17 vjeç F – 19 vjeç	M – 14-15 vjeç F - 15-16 vjeç

Pasi u pa se konsistenca e brendshme e dy shkallëve të pacenueshmërisë (PR dhe PP) ishte e konsiderueshme (PR: $\alpha = .72$ dhe PP: $\alpha = .75$), u vijua më tej me synimet e studimit. Testimi i hipotezës kryesore me anë të nën hipotezave të ndryshme ofroi të dhëna interesante, të pritshme ose jo. Ajo çfarë pretendohet nga ky studim është të provohet se *pacenueshmëria* dhe *sjelljet e rrezikshme* kanë korrelacion mes tyre. Nëse provojmë ekzistencën e një korrelacioni të tillë (për studimin tonë më N=140 pjesëmarrës), atëherë mund t'i lejojmë vetes të mendojmë se pacenueshmëria është një proces zhvillimor normativ dhe jo një gabim konjitiv në mënyrën sesi individët vlerësojnë ngjarjet negative (Lapsley et al, 2005).

Në vështrimin e Tabelës 5 vihet re se PR ka marrëdhënie statistikisht të rëndësishme me katër prej indikatorëve të përdorimit të substancave. Ndër rezultatet e pritshme ishin korrelacionet pozitive mes PR e *konsumimit të substancave narkotike* si dhe PR e *sasisë së pijeve të konsumuara në një javë*. Këto marrëdhënie ishin të pritshme duke patur parasysh rezultatet e Hill et al (2010) ku PR lidhej me prevalencën jetësore të përdorimit të substancave narkotike si dhe frekuencën e përdorimit të tyre. Ky studim përfundoi se PR ishte një parashikues i përdorimit të substancave. Studimi i Aasla et al (2006) mbështet gjithashtu gjetjet tona duke konkluduar se PR ishte një parashikues i rëndësishëm i sjelljeve të rrezikshme si përdorimi i duhanit, alkoolit dhe substancave narkotike. PR pra shkon në linjë të drejtë me këto dy variabla duke mbështetur mendimin se konsumimi i substancave narkotike apo sasia e pijeve të konsumuara gjatë një jave, shërbejnë si indikatorë tregues të nivelit të ndjesisë së pacenueshmërisë.

Dy indikatorët e tjerë të përdorimit të substancave të lidhur me PR janë *mosha e fillimit të konsumimit të duhanit* dhe *mosha e fillimit të konsumimit të alkoolit*. Të dy këto variabla krijojnë një lidhje negative me konstruktin e PR. Ky rezultat ishte i pritshëm pasi një moshë e ulët e fillimit të konsumimit të substancave është një tregues se pacenueshmëria ndaj rrezikut është e lartë dhe pasojat nuk mendohen si kërcënuese nga ana e individit. Këto gjetje mund të qëndrojnë në të njëjtën kornizë teorike me konceptin e “fabulës personale” të Ikind (1967, 1985, cituar tek Hill et al., 2010: 2) ku adoleshenti ndërton një fabulë pavdekshmërie e cila e predisponon të mendojë se pasojat dëmtuese ka më shumë gjasa t'i ndodhin të tjerëve sesa atij vetë, duke ndikuar kështu vendim-marrjen edhe për përdorimin apo jo të substancave. PR krijon korrelacion negativ edhe me *moshën e kryerjes së marrëdhënies së parë seksuale*. Studime të ngjashme përsa i përket moshës së fillimit të aktivitetit seksual nuk u gjetën, por rezultatet e studimit tonë mund të gjejnë mbështetje në pikëpamje teorike si “fabula personale” e përmendur më lart, e cila ka një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me konceptin e pacenueshmërisë (Hill et al. 2010).

Variabli i fundit me të cilin PR krijon një korrelacion të rëndësishëm është *gjinia*. Sipas korrelacionit kuptojmë se PR është më e madhe për meshkujt sesa për femrat. Edhe ky rezultat ishte i pritshëm duke marrë parasysh studimet e ndryshme të cilat kanë pasur të njëjtat rezultate. Përmendim këtu studimin e Lapsley & Duggan (2001) ku u raportua se meshkujt kishin ndjenja më të mëdha pacënueshmërie sesa femrat. I njëjti rezultat u replikua në një studim të Alberts, Elkind & Ginsberg (2006) ku meshkujt raportuan pikë invulnerabiliteti në mënyrë të konsiderueshme më shumë se femrat. Shpjegimet për këtë fakt mund të jenë nga më të shumtat duke filluar që nga brendësimi i roleve gjinore të ofruara që djep ku mashkulli kërkohet të jetë i fortë e të mos ketë frikë, të eksplorojë mjedisin e të mësojë nga eksperiencia, ndërsa femrave u induktohet ideja se ato kanë nevojë për mbrojtje e këtë mund t'ia ofrojë një mashkull. Femrat kështu priren të brendësojnë idenë se duhet të jetë e kujdesshme kur ndërveprojnë me mjedisin pasi rreziku për to ndodhet kudo. Argument tjetër e ndoshta ndër më të dukshmit është ndryshimi biologjik mes meshkujve dhe femrave ku superioriteti i forcës fizike mashkullore është një ndër sigurimet më të mëdha që një mashkull mund t'i japë ndjesisë së të tij të pacënueshmërisë.

Megjithatë PR nuk shfaqi lidhje statistikisht të konsiderueshme për të gjithë variabilet. Një ndër rezultatet që nuk parashikoheshin ishte mungesa e rëndësisë statistikore mes PR dhe përdorimit të mjeteve mbrojtëse. Megjithëse drejtimi i lidhjes ishte negativ (pra sa më i ulët përdorimi i mjeteve mbrojtëse, aq më e lartë PR) dhe mund t'i shërbente mbështetjes së nën hipotezës tonë, lidhja nuk u shfaq si e rëndësishme. Ndoshta, arsyeja e këtij përfundimi mund të kuptohet nëse të kthehemi tek të dhënat e rezultateve deskriptive. Aty vihet re se përqindja e pjesëmarrësve të cilët kanë raportuar përdorimin e mjeteve mbrojtëse është njëjtë e lartë, 78.3%. Një shifër kaq e lartë është tregues i homogjenitetit të kampionit, fakt që çon drejt mungesës së një lidhjeje sinjifikative mes PR dhe kësaj sjelljeje. Përqindja e madhe e përdorimit të mjeteve mbrojtëse mund të ndikohet nga njohuritë e pjesëmarrësve mbi IST (Subashi, 2014). Faktor tjetër ndikues është niveli i arsimimit dhe social-ekonomik siç raportohet nga UNFPA (ADHS 2008-09). Megjithatë mungesa e të dhënave mbi nivelin arsimor dhe ekonomik të pjesëmarrësve në studimin tonë na pengon të shkojmë drejt konkluzioneve të sakta. I njëjti studim ka raportuar gjithashtu se risku për mos-përdorimin e kondomit është më i ulët në Tiranë çka mund të merret si e dhënë argumentuese e rezultateve tona duke marrë parasysh se pjesa më e madhe e pjesëmarrësve të studimit janë banues në Tiranë.

Përsa i përket PP, korrelacioni me dy prej variabileve (*mosha e pjesëmarrësve* dhe *mosha e fillimit të konsumimit të duhanit*) rezultoi statistikisht i rëndësishëm. Korrelacioni i parë është mes PP dhe moshës së pjesëmarrësve. Korrelacioni është negativ dhe na sugjeron se sa më e vogël mosha e individit, aq më e madhe PP. PP është konceptuar nga autori si zotërim i mirë i aftësive përbaluese dhe adaptuese të cilat nxisin një rregullim pozitiv të individit. Në fakt, studimi Hill et al. (2010) ku u vu re se kishte një marrëdhënie pozitive mes konceptit të pacënueshmërisë psikologjike dhe sjelljeve rregulluese në adoleshencë nuk përputhet me rezultatet e studimit tonë. Të dhënat e studimit tonë bien ndesh me propozimin se PP është në fakt indikator i sjelljeve përshtatëse. Sipas Tabelës 5 mund të shohim se PP krijon lidhje negative me moshën e pjesëmarrësve si dhe moshën e fillimit të konsumimit të duhanit. Kjo do të thotë se sa më e vogël mosha e fillimit të konsumimit të duhanit, aq më e madhe PP. Në bazë të interpretimit të Hill, kjo lidhje do të nënkuptonte se sa më herët të fillojë konsumimin e duhanit një adoleshent, aq më tepër aftësi rregulluese e menaxhuese do të ketë ai. I njëjti diskutim vlen dhe për moshën e pjesëmarrësve ku sa më e vogël mosha, aq më e madhe PP, pra aftësia përbaluese e rregulluese.

Menaxhimi me efektivitet i situatave është sjellje karakteristike e maturimit dhe si e tillë shfaqet tek individit në fillimin e moshës së rritur (Furstenber, 2005). Raste të veçanta do të ishin ato në të cilat një adoleshent ka aftësi të mira adaptuese çka është indikator i maturitetit. Por në rastin e një kampionimi prej 140 personash ku pjesa më e madhe e tyre karakterizohej nga një PP e lartë, nuk mund të pretendojmë se të gjithë këta persona janë raste të veçanta maturimi të parakohshëm. Për të gjetur një lidhje akoma më të fortë mes pretendimeve tona mohuese ndaj rezultateve të Hill et al. (2010), i rikthehem Tabelës 5 dhe shikojmë se mes dy konstrukteve të pacënueshmërisë, pra mes PR dhe PP, kemi një korrelacion pozitiv statistikisht të vlefshëm. Me anë të këtij korrelacioni mundemi të përparojmë një shkallë përpara duke gjetur hallkën lidhëse mes rezultateve dhe shpjegimit të tyre. Të paturit të një marrëdhënieje pozitive mes PR dhe PP tregon se me rritjen e njërës, do të rritet dhe tjetra. Por në qoftë se PP do të ecë në një linjë me PR, atëherë duhet të pranojmë se PP do të ecë në një linjë me ndjenjën e pacënueshmërisë ndaj rrezikut dhe sjelljeve të rrezikshme për shëndetin. Në këtë mënyrë, PP nuk shfaqet më si një indikator i mirë-adaptimit, por bashkohet në të njëjtën linjë keq-adaptuese të PR.

Mënyra sesi mund ta interpretojmë PP në këtë pikë do të na nxiste të mendonim se PP nuk është pra indikator i sjelljes rregulluese (maturimit), por është indikator i prirjeve jo-realiste të individit ndaj kapaciteteve të veta. Mund të dalim në një përfundim të tillë pasi marrim në shqyrtim pyetje të tilla të pyetësorit si “Ndjenjat e mia nuk lëndohen”.

Ulja e egocentrizmit me rritjen e moshës do të çojë dhe në eliminimin e fenomeneve të tilla si “audiencia imagjinare” dhe “fabula personale” çka na nxisin të mendojmë se arsyet e fillimit të konsumimit të duhanit në moshë të vogël do të kenë një bazë individuale dhe nuk do të kryhen si pasojë e influencës shoqërore, dëshirës për të bërë përshtypje apo perceptimit të ulët të riskut (siç është karakteristike për adoleshencën). Konsumimi i duhanit që në moshë të vogël mund të nxitet edhe nga faktorë të tjerë siç mund të jenë dëshira për eksperimentim, pranimi shoqëror, dëshira për t'u dukur si i rritur, identifikimi me sjelljet e prindërve etj. (APA, 2002: 30).

Mes PP dhe variabileve të tjerë mungonte një lidhje statistikisht e rëndësishme. Moshja e kryerjes së marrëdhënies së parë seksuale ka një lidhje me PP, por kjo lidhje nuk është ende e rëndësishme statistikisht, gjë kjo e cila mund të ndikohet nga kampioni i vogël i studimit. PP si indikator duket se nuk ka të njëjtën konsistencë kulturore, le ta quajmë kështu, siç ka PR. Përfitimi i rezultateve të ndryshme mes studimeve në kultura të ndryshme, herë përbush pritshmëritë e herë surprizon kërkuesin. E rëndësishme është se studime të tilla provojnë çdo ditë e më shumë rëndësinë e diversitetit si gjenerues ndryshimesh e dinamikash.

Përfundime e rekomandime

Qëllimi i studimit ishte të shqyrtonte mënyrën sesi koncepti i pacenueshmërisë lidhet me sjelljet e rrezikshme për shëndetin në kontekstin shqiptar, duke u fokusuar në periudhën e adoleshencës. Për të realizuar këtë qëllim u testua hipoteza e cila shqyrtonte lidhjen midis dy dimensioneve të pacenueshmërisë (pacenueshmëria ndaj rrezikut dhe pacenueshmëria psikologjike) dhe tre sjelljeve të rrezikshme (dhe indikatorëve përkatës). Rezultatet treguan si PR lidhet me përdorimin e substancave narkotike, gjininë e studentëve, moshën e kryerjes së marrëdhënies së parë seksuale, moshën e fillimit të konsumimit të duhanit, alkoolit si dhe sasinë e pijeve të konsumuara në një javë. Rezultatet gjithashtu treguan se PP lidhet me moshën e pjesëmarrësve dhe moshën e fillimit të konsumimit të duhanit.

Rezultatet e studimit tonë marrin vlerë në kontekstin praktik. Të kuptuarit e nivelit të pacenueshmërisë dhe mënyrën sesi ajo lidhet me sjellje të rrezikshme mund të na ndihmojë në identifikimin e individëve me prirje të lartë pacenueshmërie dhe në ndërhyrjen për parandalimin e krijimit të marrëdhënies pacenueshmëri-sjellje e rrezikshme. Ndërhyrja parandaluese mund të zhvillohet në tre nivele (prindër, mësues, psikolog shkollor) dhe t'u shërbejë po prapë këtyre niveleve. Këto tre nivele duhet më pas të veprojnë në mënyrë të ndërsjellë me adoleshentin dhe mes njëri-tjetrit.

Ky studim hodhi dritë mbi disa rezultate interesante, rëndësia e të cilave nuk mund të vlerësohet plotësisht deri në momentin e ekzistencës së studimeve të tjera të kësaj natyre. Studime të mëtejshme në kontekstin shqiptar janë të nevojshme për të kuptuar ndikimin e faktorit social-kulturor mbi pacenueshmërinë, faktor ky i cili supozohet të jetë shpjegues për rezultatet e paparashikuara të korrelacioneve të PP në studimin tonë.

Studimet cilësore me adoleshentë janë një hap tjetër studimor i rëndësishëm që duhet ndërmarrë për të kuptuar në mënyrë më të thelluar pikëpamjet dhe sjelljet adoleshenciale të lidhura me pacenueshmërinë. Analiza e lidhjeve mes studimeve *cilësore e sasiore* do të prodhonte një studim gjithëpërfshirës, rezultatet e të cilit jo vetëm do të hidhnin dritë mbi sjelljet e adoleshentëve, por do të krijonin dhe një ide mbi dinamizmat e përjetimit të adoleshencës në Shqipëri.

Bibliografia

- Aalsma, M., Lapsley, D. K. & Flannery, D. (2006). Narcissism, personal fables, and adolescent adjustment. *Psychology in the Schools*, 43, 481-491. Marrë nga: http://www.researchgate.net/publication/227714663_Personal_fables_narcissism_and_adolescent_adjustment/file/e0b49528a554d040f7.pdf (Aksesuar: 13 qershor 2014)
- Alberts, A., Elkind, D. & Ginsberg, S. (2006). The personal fable and risk-taking in early adolescence. *Journal of Youth Adolescence*, 36, 71-76
- American Psychological Association. (2002). *Developing adolescents: A reference for professionals*. Marrë nga <http://www.apa.org/pi/families/resources/develop.pdf> (Aksesuar: 27 qershor 2014)
- Association of Maternal and Child Health Programs., & National Network of State Adolescent Health Coordinators. (2005). *A conceptual framework for adolescent health*. Marrë nga <http://www.amchp.org/programsandtopics/AdolescentHealth/Documents/conc-framework.pdf> (Aksesuar: 16 qershor 2014)
- EMCDDA. (2009). *Country Overview: Albania 2009*. Marrë nga <http://www.emcdda.europa.eu/publications/country-overviews/al> (Aksesuar: 13 qershor 2014)
- ESPAD (2011). *The 2011 ESPAD Report: Substance Use Among Students in 36 European Countries*. Marrë nga http://www.can.se/PageFiles/2619/The_2011_ESPAD_Report_FULL.pdf?epslanguage=sv (Aksesuar: 14 qershor 2014)
- Gazeta Shqip. (2013, 13 Prill). Zakoni i duhanit trashëgohet nga prindërit. *Gazeta Shqip*. Marrë nga <http://gazeta-shqip.com/lajme/2013/04/13/zakoni-i-duhanit-trashegohet-nga-prinderit/> (Aksesuar: 14 qershor 2014)
- Hill, P. L., Duggan, P. M. & Lapsley, D. K. (2010). Subjective invulnerability, risk behaviour, and adjustment in early adolescence. *The Journal of Early Adolescence*, 32: 489-501
- INSTAT, ISHP. (2010). *Albania Demographic and Health Survey 2008-09*. Marrë nga <http://dhsprogram.com/pubs/pdf/FR230/FR230.pdf> (Aksesuar: 21 qershor 2014)
- ISHP. (2013.b). *Vlerësimi i sjelljeve të lidhura me shëndetin tek fëmijët e moshës shkollare: Raport i studimit të kryer në Shqipëri në vitin 2012/2013 me protokollin e vitit 2009/2010*
- Kipke, M. D., Institute of Medicine., & National Research Council (U.S.). (1999). *Risks and opportunities: Synthesis of studies on adolescence: forum on adolescence*. Washington, D.C: National Academy Press. Marrë nga http://www.nap.edu/openbook.php?record_id=9721&page=R1 (Aksesuar: 10 qershor 2014)
- Lapsley, D.K., Aalsma, M.C. & Halpern-Felsher, B.L. (2005). *Invulnerability and risk behavior in early adolescence*.
- Lapsley, D. K. & Duggan P. M. (2001). *The Adolescent Invulnerability Scale: Factor Structure and Construct Validity*. Marrë nga http://www3.nd.edu/~dlapsle1/Lab/Scales_files/Adolescent%20Invulnerability%20Scale%20and%20Scoring%20Revised.pdf (Aksesuar: 19 qershor 2014)
- Lapsley, D. K. & Hill, P. L. (2009). Subjective invulnerability, optimism bias and adjustment in emerging adulthood. *Journal of Youth and Adolescence*, 8, 847-857.
- Levesque, R. J. R. (2011). Invulnerability. In *Encyclopedia of adolescence*. (Vol. 1, p. 1489). New York, Heidelberg & London: Springer. Marrë nga http://books.google.al/books?id=VdPGF1tFDJsC&printsec=frontcover&source=gbs_ge_summary_r&cad=0#v=onepage&q&f=false (Aksesuar: 20 qershor 2014)
- McCarty et al. (2004). Continuity of Binge and Harmful Drinking From Late Adolescence to Early Adulthood. *Pediatrics* 2004; 114:3 714-719
- Mërkuri, L. (2013). *Vlerësimi i njohurive, qëndrimeve dhe sjelljeve rreth infeksioneve seksualisht të transmetueshme te studentët e universiteteve shqiptare* (Disertacion Doktorale). Marrë nga <http://www.umed.edu.al/medicine/images/Doktoraturat-PDF/>

- Disertacion-Lumturi-Merkuri.pdf (Aksesuar: 10 qershor 2014)
- Millstein, S., & Halpen-Felsher, B. (2002) Judgments about Risk and Perceived Invulnerability in Adolescents and Young Adults. *Journal of Research on Adolescence*, 12, 399-
- Ravert, D. R. et al. (2009). Sensation seeking and danger invulnerability: Paths to college student risk-taking. *Journal of Personality and Individual Differences*. 47. 763-768. Marrë nga https://www.google.com/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=1&cad=rja&uact=8&ved=0CB4QFjAA&url=http%3A%2F%2Fwww.sciencedirect.com%2Fscience%2Farticle%2Fpii%2FS0191886909002803&ei=zjW5U4qXG8nP4QTRyoDYCA&usg=AFQjCNH_1NPWOXoqK2OacBQ21OOOpOeY9rg&sig2=qEuLArvN5HWy33MfNnjRiw&bvm=bv.70138588,d.bGE (Aksesuar: 13 qershor 2014)
- Subashi, A. (2014). Perceptions of sexual behavior and knowledge about STI among young people in Tirana, Albania. *European Scientific Journal*. 3. 2014. UCLA Center for Health Policy Research. (2009-2010). *CHIS 2009 Adolescent questionnaire Version 7.8*. Marrë nga <http://healthpolicy.ucla.edu/chis/design/Documents/CHIS2009teenquestionnaire.pdf> (Aksesuar: 16 qershor 2014)
- UNFPA, UNICEF. (2011). *Albanian Demographic and Health Survey (ADHS 2008 -09)*. Marrë nga http://www.unicef.org/albania/ADHS_secondary_analysis.pdf (Aksesuar: 12 qershor 2014)
- USAID. (2006). Albania - Behavioral and biological surveillance study report. Marrë nga <https://www.globalhivmeinfo.org/DigitalLibrary/Digital%20Library/Albania%20-%20Behavioral%20and%20Biological%20Surveillance%20Study%20Report.pdf> (Aksesuar: 10 qershor 2014)
- WHO. (2013). *WHO Report on the Global Tobacco Epidemic. Country Profile: Albania*. Marrë nga http://www.who.int/tobacco/surveillance/policy/country_profile/alb.pdf (Aksesuar: 17 qershor 2014)

REAGIMET E NXËNËSVE GJATË PËRBALLJEVE ME AKTIVITETE INOVATIVE NË SHKOLLË

FATMIR AGAJ

PhD. Kandidat në Universitetin European të Tiranës, Fakulteti i shkencave sociale - Pedagogji

ABSTRAKT

Ky punim ngërthen në vete të vlerësuarit e reagimeve të nxënësve në momentet kur ata përballen me inovacione mësimore. Andaj, në këto raste tek nxënësit mund të shihet qartë ndjenja aktive e përballjes me to dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e të menduarit kritik, analizues dhe veprues. Këtij hulumtimi iu kemi qasur nga arsyeja se nxënësit e shkollës sonë, kanë nevojë më tepër të njihen me inovacione mësimore, ngase ato në procesin mësimor, zënë një vend mjaft të rëndësishëm në pasurimin e përvojave në të nxënësve. Andaj, këto veprimtari i ndihmojnë nxënësit të motivohen, rrisin njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat e tyre, si dhe zgjojnë interesim më të madh për ta dashur më shumë shkollën. Qëllimi i këtij punimi, është pasqyrimi i gjendjes reale të reagimeve të nxënësve në situata kur inovacionet janë prezentë në shkollë në raport me situata kur ato mungojnë. Pyetja kërkimore e hulumtimit është: Si reagojnë nxënësit në situata kur përballen me inovacione mësimore? Me qëllim për të vlerësuar dhe krahasuar reagimet e nxënësve për rolin dhe rëndësinë e inovacioneve në shkollë dhe klasë, kemi përdorur disa prej metodave themelore përmes të cilave kemi hulumtuar këtë problem mjaft të ndjeshëm në shkollën fillore, “Dëshmorët e kombit”, Kamenicë, Kosovë. Mostra e hulumtimit përbëhet prej 50 nxënësve të kësaj shkolle, ku nga rezultatet e hulumtimit kemi ardhur në përfundim se në shkollën fillore, “Dëshmorët e Kombit” nga Kamenica, në situata kur praktikohen inovacionet mësimore, nxënësit janë më aktiv në klasë dhe shkollë dhe se të gjithë janë të vetëdijshëm për rëndësinë e tyre dhe efektet pozitive që sjellin ato tek nxënësit. Andaj, edhe rezultatet e hulumtimit kanë treguar të vërtetën se nxënësit janë plotësisht të kënaqur me inovacionet mësimore. Rekomandimet e dala nga ky studim ndoshta do të ngrenë vetëdijen e të gjithë pjesëmarrësve të jetës shkollore dhe do të kontribuonin në shtimin e inovacioneve mësimore në shkollë, ku përfitues të drejtpërdrejtë do të jenë nxënësit.

Fjalë kyç: *reformë, inovacion, aktivitete novative, reagimi i nxënësve*

Hyrja

“Qëllimi kryesor i arsimimit është të krijojë njerëz, që janë të aftë të bëjnë gjëra të reja, jo thjeshtë të përsëritin ato që kanë bërë brezat e tjerë-njerëz që janë krijuar, shpikës dhe zbulues. Qëllimi i dytë i arsimimit është të formojë mendje, që mund të jenë kritike, që të mund të verifikojnë dhe jo të pranojnë çdo gjë që u jepet” (Musai, 2008: 11)

Mësuesit duhet të kujdesen që të lejojnë më shumë nxënësit që të flasin për veten e tyre, të dëgjojnë vazhdimisht atë që kanë për të thënë, të inkurajojnë ata që të reagojnë për gjithçka që ndodh në klasë dhe të tregojë interesim për të gjitha ato risi që dëgjon nga nxënësit e tij.

Sot, në kohën e kompjuterizimit dhe të mundësive të pakufizuara të Internetit, me më shumë rëndësi është që nxënësi të mësojnë si t’i gjejnë informacionet e nevojshme, se sa t’i memorizojë faktet që i ka thënë mësuesi. Gjithashtu, është e rëndësishme që secili nxënës përafërsisht të jetë i gatshëm që ai vet t’i zhvillojë potencialet e tij. Në shekullin XXI do të kemi nevojë për njerëz të cilët mund të zgjedhin probleme komplekse edhe të gjejnë teknika të reja efektive për kryerje më të mirë të punës. Këtë duhet ta kuptojnë të gjitha palët e përfshira në procesin edukativo-arsimor, ata që e krijojnë politikën e arsimit, si dhe ata të cilët janë drejtpërdrejtë të përfshirë në mësim, siç janë: mësuesit, nxënësit dhe prindërit.

Të dinë për të rejat e fundit, pra të përcjellin me vëmendje çdo ndryshim. Sepse, kështu ata do të kenë vetëbesim dhe do të jenë më të sigurt në orën e mësimit, ku nxënësit mund të jenë kureshtarë për çështje të caktuara. Mësuesit duhet të synojnë thellimin e të kuptuarit të teorive të destinuar për forcimin e praktikave të të mësuarit dhe të mësimdhënies.

Në këtë punim kemi trajtuar problemin rreth reagimeve të nxënësve në situata kur inovacionet janë prezentë në shkollë, e sidomos në ato raste kur nxënësit për herë të parë përballen me inovacione mësimore.

Duke vërtetuar shumë herë se mësimdhënësit janë faktorët kryesor në gjetjen dhe sjelljen e inovacioneve në shkollë, atëherë, patjetër që edhe unë si mësimdhënësit e tjerë, jam i obliguar dhe i motivuar në sjelljen e inovacioneve mësimore tek nxënësit si: përmes fjalëve, shkrimeve, modeleve, formave, metodave, teknikave dhe teknologjive mësimore etj, me qëllim që nxënësit të jenë më aktiv në klasë dhe të reagojnë pozitivisht në situata kur përballen me to.

Ky problem, është mjaft interesant dhe tërheqës për t’u diskutuar, sidomos tani kur e gjithë bota moderne harxhon shuma marramendëse për të sjellë risi, në mënyrë që njerëzimi të ballafaqohet më lehtë me problemet e saja. E njëkohësisht edhe shkollat, vazhdimisht janë në pritje të inovacioneve mësimore, ku për nxënësit do të jetë më i lehtë përballja me problemet e shkollës.

Këtij punimi iu kemi qasur nga arsyeja se sikurse nga brenda ashtu dhe nga jashtë objekteve tona shkollore, jemi të rrethuar me lloje të shumta risish, por, prapë se prapë disa nga mësimdhënësit bëhen sikur të shurdhër dhe po thuajse fare pak merren me implementimin e inovacioneve mësimore në shkollat e tyre. Andaj, ia vlen të punohet, me qëllim që mësimdhënësit përmes inovacioneve të ndikojnë pozitivisht në shtimin e rezultateve të nxënësve dhe krijimin e dashurisë së tyre ndaj shkollës.

Praktikat e përditshme shkollore kanë treguar se sjellja e risive nga jashtë – brenda, nga ana e institucioneve të arsimit, mësimdhënësve, komunitetit dhe nxënësve, na bënë të ecim gjithnjë me kohën. Andaj, sfida e këtij punimi, po edhe e shoqërisë sonë bashkëkohore, është dhe do të jetë: synimi drejt një të ardhme të një shkollë më të ndritur se sa e tanishmja.

Zbardhja e këtij hulumtimi, do t’i jap kontributin e vet në bindjen e mësimdhënësve dhe komunitetit në përgjithësi se përmes zbatimit të inovacioneve në shkollë, në formën direkte apo indirekte, do të ndikoj pozitivisht tek nxënësit në kthimin e vëmendjes nga shkolla.

Andaj, unë mendoj se zgjedhja e këtij problemi, do një vullnet dhe seriozitet profesional, dhe mobilizim të përbashkët mes mësimdhënësve në bashkëpunim me komunitetin dhe institucionet arsimore, për të qenë më afër me risitë e përditshme, që pothuajse janë kudo rreth nesh, e që pastaj ato të bartën në shkollë, me qëllim që ato të marrin një pamje më tërheqëse për t’i bërë nxënësit të reagojnë më ngrohtë ndaj mësimdhënësit dhe shkollës në përgjithësi.

Pyetja kërkimore e hulumtimit tonë, është: Si reagojnë nxënësit në situata kur përballen me inovacione mësimore? Lidhur me këtë problem, kemi përdorur edhe disa prej metodave themelore, sidomos metodat sasiore përmes të cilave kemi hulumtuar këtë problem mjaft të ndjeshëm për shkollën fillore, “Dëshmorët e kombit” të Kamenicës. Ndërsa, si instrument matës lidhur me qëndrimet e nxënësve, kemi aplikuar edhe teknikën e anketimit – pyetësorin. Pasi që popullacioni ishte mjaft i madh dhe pasi që në këtë shkollë zbatoheshin të njëjtat praktika shkollore, atëherë kemi marrë mostrën prej 50 nxënësve nga gjitha klasat (I – IX).

Nga rezultatet e hulumtimit tonë, kemi ardhur në përfundim se shumica dërmuese e nxënësve të kësaj shkollë, janë të mendimit se në momente kur përballen për herë të parë me inovacionet mësimore, sikurse në klasë po ashtu edhe në infrastrukturën shkollore, nxënësit në të shumtën e rasteve reagojnë qetë dhe pozitivisht, ngase gjërat që paraqiten për herë të parë, ju duken më interesante, befasuese dhe më tërheqëse.

Objekt hulumtimi në këtë rast janë: Ndikimi i inovacioneve mësimore në qëndrimin e nxënësve ndaj shkollës. Andaj, për këtë, jo vetëm mësimdhënësit, por edhe institucionet arsimore dhe komuniteti në përgjithësi, duhet të njoftohen sa më parë rreth ndikimit të inovacioneve si element veprimi në praktikat shkollore dhe si metoda, forma dhe mjete relaksuese për të ardhur më lehtë dhe më shpejt deri tek bindja e nxënësve me qëllim për ta kthyer më tepër vëmendjen nga shkolla.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij studimi, është që t’i nxisë institucionet përgjegjëse për të menduar dhe për të marrë masa konkrete në reformën e arsimit dhe, t’i kontribuoj diskutimit të gjithanshëm që është duke u zhvilluar për reformën e arsimit në vendin tonë.

Qëllimi kryesor që më shtyu të merrem me këtë problem, është ajo se: Në shkollën fillore, “Dëshmorët e kombit” të Kamenicës, dëshirojmë të vërtetojmë reagimet e nxënësve të kësaj shkolle në raste kur përballen me inovacione mësimore. Qëllimi tjetër që më shtyu të merrem me këtë problem, është arsyeja për të matur qëndrimet e nxënësve rreth reagimeve të tyre në situata kur përballen me inovacione mësimore dhe, të bëjë krahasimin e qëndrimeve të tyre, me qëllim që ky punim sado pak të ketë ndikim pozitiv tek institucionet për t’i dhënë rëndësi më të madhe inovacioneve në praktikën shkollë.

Me këtë hulumtim synojmë të realizojmë këto objektiva: Të identifikojmë dhe pasqyrojmë format e reagimeve të nxënësve gjatë përballjes me inovacionet mësimore. Së dyti, të analizojmë efektet e inovacioneve pro dhe kundra dëshirës së nxënësve. Së treti, të analizojmë dhe vërtetojmë efektet e inovacioneve në stimulimin e nxënësve. Së katërti, të analizojmë dhe krahasojmë opinionet e të anketuarve, dhe, të ofrojmë rekomandime në drejtim të forcimit, stimulimit dhe bindjes së nxënësve për ta dashur më shumë shkollën, dhe kjo të jetë si udhërrëfyes i një shkolle të së ardhmes. Andaj, shpresojmë se hulumtimi i këtij problemi do t’na nxjerrë të dhëna shkencore lidhur me këtë çështje.

Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Pyetja kërkimore e këtij punimi është: Si reagojnë nxënësit kur përballen me inovacionet mësimore? Ndërsa, hipoteza e punimit është: Aktivitetet inovative në shkollë ndikojnë që nxënësit t’i bëjnë më të motivuar dhe, si rrjedhojë, të reagojnë pozitivisht për ta dashur më shumë shkollën.

Gjatë këtij hulumtimi kemi përdorur metodat sasiore përmes të cilave kemi hulumtuar këtë problem mjaft të ndjeshëm duke përgjithësuar dhe analizuar punimin tonë rreth reagimeve të nxënësve në situata të përballjeve me aktivitete të reja mësimore.

Nga matjet që kemi bërë në hulumtimin tonë studimor, kemi arritur të bëjmë krahasime numerike mes nxënësve që reagojnë pozitivisht gjatë përballjeve me aktivitete inovative në shkollë dhe, me nxënës që më pak apo fare nuk reagojnë në situata të tilla, dhe, më në fund kemi paraqitur të dhënat e grumbulluara nga të anketuarit (nxënësit).

Për të ardhur më lehtë deri tek hulumtimi i të dhënave, kemi përdorur pyetësorin si procedurë teknike, për t’i matur qëndrimet e nxënësve lidhur me reagimet e tyre gjatë situatave të përballjeve me inovacione mësimore.

Popullacionin e përbëjnë të gjithë nxënësit e kësaj shkolle, e cila ka një numër mjaft të madh nxënësish, por, pasi në këtë shkollë trajtohet e njëjta praktikë shkollë, andaj, nuk e kemi parë të arsyeshme që të anketohen të gjithë nxënësit. Dhe, për këtë arsye, këtë problem e kemi hulumtuar përmes mostrës që përbëhet prej 50 nxënësve duke përfshirë numër përafërsisht të njëjtë nga të gjitha klasat (I – IX).

Analizë, interpretim të dhënash

Ndërmjet organizimeve të formave dhe metodave të punës mësimore, mund të ketë edhe dallime përsa i përket punës, mësimit dhe suksesit shkollor në përgjithësi, e kështu mund të ketë dallime edhe mes reagimeve të nxënësve gjatë përballjeve me inovacione mësimore. Për këtë, kësaj radhe synojmë të dimë se sa janë dallimet dhe reagimet e nxënësve në situata të tilla. Por, krahas saj, gjithsesi duhen krijuar kushte më të mira shkollë nga mësimdhënësit dhe institucionet arsimore në implementimin e futeve të risive në praktikën shkollë.


Dihet që ndërmjet nxënësve ka edhe dallime të ndryshme sa i përket reagimeve të tyre gjatë aktiviteteve inovative në shkollë dhe klasë, por, ajo që është më e rëndësishmja është të dimë saktë se çfarë mendojnë nxënësit rreth inovacioneve. E njëherë dëshirojmë të dimë se sa janë aktiv dhe të koncentruar në klasë në situata kur përballen me inovacione mësimore.

Nga ky hulumtim nxjerrim atë që është e njohur dhe konstatim i përbashkët dhe i përgjithshëm për dukurinë dhe shkallën e ndikimit të inovacioneve në qëndrimet e nxënësve ndaj shkollës. Andaj, në këtë rast, nuk është ky vetëm një përshkrim i thjeshtë, por një përshkrim i analizës, krahasimit dhe matjeve të qëndrimeve të nxënësve të SHFMU, “Dëshmorët e kombit” të Kamenicës. Ky lloj përshkrimi na e bën të mundur të fitojmë bazë reale për lidhjen shkak-pasojë në qëndrimet pozitive apo negative të nxënësve rreth përballjes me aktivitete inovative.


Të dhënat, deri tek të cilat erdhëm me përdorimin instrumenteve, kanë qenë të rregulluara dhe të përpunuara në mënyrë statistikore që do të tregojnë të vërtetën e kërkuar.

Në pyetjen e parë: *A ndodh shpesh që në shkollën tuaj të përballeni me inovacionet mësimore?* Prej 50 nxënësve sa ishin të përfshirë në hulumtim, 26 prej tyre apo 52 % kishin deklaruar se në shkollën e tyre mjaft shpesh përballen me inovacione mësimore. Ndërsa, 22 nxënës apo 44 % të tyre, kanë deklaruar se nuk përballen shpesh me inovacione mësimore dhe, 2 prej tyre apo 4 % kishin deklaruar se fare nuk ndodh të përballen me inovacione. Nga këto të dhëna, na lë të kuptojmë se shumica e nxënësve, pothuajse kanë dhënë të njëjtin mendim duke deklaruar se në shkollën e tyre, kanë rastin që të përballen mjaft shpesh me inovacione mësimore. Shih për këtë grafikun nr.1:

Në pyetjen: *A mendoni se në shkollën tuaj duhet të aplikohen më tepër inovacione mësimore?* Prej 50 nxënësve të anketuar, sa ishin të përfshirë në hulumtim, 23 prej tyre ose 46 % të tyre kishin deklaruar se në shkollën e tyre, gjithsesi ka nevojë më tepër për inovacione mësimore. Kurse, 20 prej tyre apo 40 % kishin deklaruar se shkolla ku ata mësojnë, për inovacione mësimore ka nevojë deri diku. Dhe, 7 prej tyre apo 14 % kishin deklaruar se shkolla e tyre nuk ka nevojë për inovacione. Nga qëndrimet përgjithshme të nxënësve lidhur me kërkesat apo nevojat e tyre rreth inovacioneve mësimore në shkollën e tyre, një pjesë e


FIGURA NR. 1. QËNDRIMET E NXËNËSVE LIDHUR ME PËRBALLJEN E INOVACIONEVE NË SHKOLLË.

madhe e tyre janë deklaruar që shkolla e tyre gjithsesi ka nevojë që të ketë më tepër inovacione mësimore. Kurse, pjesa tjetër ishin si të dyshimtë, ngase mendojnë se shkolla e tyre është mjaft e pasur me inovacione mësimore. Shih për këtë grafikun nr. 2

GRAFIKU NR. 2. QËNDRIMET E NXËNËSVE LIDHUR ME KËRKESËN E APLIKIMIT TË INOVACIONEVE MËSIMORE NË SHKOLLËN E TYRE.


Në pyetjen e radhës: *A ndikojnë inovacionet në pasurimin tuaj me njohuri të reja mësimore?* Prej 50 nxënësve sa ishin të përfshirë në hulumtim, 42 prej tyre apo 84 % kishin deklaruar se inovacionet ndikojnë mjaft shumë në pasurimin e tyre me njohuri të reja mësimore. Kurse, 6 prej tyre apo 12 % kishin deklaruar se nevoja e tyre për inovacione është deri diku. Dhe, 2 prej tyre ose 4 % kishin deklaruar se inovacionet aspak nuk ndikojnë në pasurimin e tyre me njohuri të reja mësimore.

Nga qëndrimet e shumicës së nxënësve, vërehet qartë se inovacionet ndikojnë mjaftueshëm në pasurimin e nxënësve me njohuri të reja mësimore, ngase ata në shumicën e rasteve janë në pritje të ndryshimeve që duhet ndodhin në shkollën e tyre. Shih për këtë grafikun nr. 3.

GRAFIKU NR. 3. QËNDRIMET E NXËNËSVE LIDHUR ME NDIKIMIN E INOVACIONEVE NË PASURIMIN E TYRE ME NJOHURI TË REJA MËSIMORE.

Në pyetjen: Përbaljet me *inovacionet mësimore, a zgjojnë interesimin tuaj për t'a dashur më shumë shkollën?* Prej 50 nxënësve sa ishin të përfshirë në hulumtim, 37 prej tyre apo 74 % kishin deklaruar se përbaljet me inovacionet mësimore zgjojnë mjaft shumë interesimin e tyre për t'a dashur më shumë shkollën. Ndërsa, 12 nga ta apo 24 % kishin deklaruar se inovacionet mësimore jo çdoherë zgjojnë interesim tek ta për ta dashur shkollën. Dhe, 1 prej tyre apo 2 % kishin deklaruar se inovacionet aspak nuk ndikojnë tek ta për ta dashur shkollën. Nga kjo na lë të kuptojmë se shumica absolute e nxënësve kanë deklaruar se inovacionet mësimore, zgjojnë interesim mjaft të madh tek nxënësit për ta dashur jo vetëm shkollën, por gjithçka që ka të bëjë brenda dhe jashtë saj. Shih për këtë grafikun nr. 4.


GRAFIKU NR. 4. QËNDRIMET E NXËNËSVE LIDHUR ME NDIKIMIN E INOVACIONEVE NË ZGJIMIN E INTERESIMIT TË NXËNËSVE PËR TA DASHUR SHKOLLËN.



Në pyetjen e radhës: *Sa jeni të mendimit se inovacionet duhet të jenë pjesë përbërëse e shkollës suaj?* Prej 50 nxënësve sa ishin të përfshirë në hulumtim, 43 prej tyre ose 86 % kishin deklaruar se inovacionet patjetër duhet të jenë pjesë përbërëse e shkollës së tyre. Kurse, 7 nga ta ose 14 % kishin deklaruar se inovacionet mësimore mund të jenë pjesërisht pjesë e shkollës së tyre. Dhe, asnjë nga ta nuk kanë deklaruar se inovacionet mësimore nuk duhet të jenë pjesë e shkollës së tyre.

Nga këto qëndrime të nxënësve lidhur me inovacionet mësimore si pjesë përbërëse e shkollës, shumica e tyre janë të mendimit se ato patjetër duhet të jenë pjesë e shkollës së tyre. Shih për këtë grafikun nr. 5.

GRAFIKU NR. 5. QËNDRIMET E NXËNËSVE LIDHUR ME INOVACIONET MËSIMORE SI PJESË PËRBËRËSE TË SHKOLLËS.



Lidhur me reagimet e nxënësve në situata kur përballen me inovacione mësimore dhe në situata kur nuk përballen me inovacione mësimore, nxënësit kanë dhënë këto përgjigje:

Nga 50 nxënës të anketuar, pothuajse kanë dhënë mendime të shumta dhe të ndryshme si për njëjërën pyetje ashtu edhe për tjetrën. Andaj, nga përgjigjet e nxënësve, jemi munduar t'i nxjerrim vetëm disa më kryesoret nga të cilat kemi mundur të kuptojmë se nxënësit në situata kur përballen me inovacione mësimore, janë më të relaksuar, shkëmbejnë ide të lira mes vete, janë më aktiv në shkollë, ndihen më të sigurt dhe më gazmorë, bashkëpunojnë në zgjidhjen e problemeve etj. Kurse, në situata kur nxënësit nuk përballen me inovacione mësimore, nuk e kanë vullnetin e mirëfilltë për të shkuar në shkollë, ndiejnë lodhje psiko-fizike, nuk janë të koncentruar sa duhet tek mësimdhënësi, ora mësimore ju duket shumë e gjatë, me padurim presin të bie zilja etj. Shih për këtë tabelën nr. 1.

TABELA NR. 1. OPINIONET E NXËNËSVE LIDHUR ME SITUATA KUR NXËNËSIT PËRBALLEN ME INOVACIONE DHE NË SITUATA KUR FARE NUK PËRBALLEN ME TO.

Nr.	Si reagoni në situata kur përballemi me inovacione mësimore?	Nr.	%
1	Jemi më të relaksuar	16	32
2	Shkëmbejmë ide mes vete	3	6
3	Jemi më aktiv në shkollë dhe klasë	5	10
4	Ndihemi më të sigurt dhe më gazmorë	10	20
5	E kemi më lehtë të bashkëpunojmë në zgjedhjen e problemeve	16	32
Nr.	Si reagoni në situata kur fare nuk përballemi me inovacione mësimore?	Nr.	%
1	Nuk e kemi vullnetin e mirëfilltë të shkojmë në shkollë	11	22
2	Ndiejmë lodhje psiko-fizike	9	18
3	Nuk jemi të koncentruar mjaftueshëm në mësimnxënie	7	14
4	Ora mësimore na duket shumë e gjatë	13	26
5	Me padurim presim të bie zilja	10	20

Konkluzione

Fëmijëve u duhet siguruar një mjedis për të nxënit i cili ofron eksperiencë më të ndryshme, me anë të cilave do t'u ndihmohet në zhvillimin e tyre social, intelektual, fizik dhe emocional në mënyrë të përshtatshme të moshës dhe të nivelit të zhvillimit të tyre. Nevoja për ndryshime në arsimin e shekullit XXI, është shumë e rëndësishme në qoftë se merren parasysh ndryshimet e shpejta të cilat po ndodhin në botën e zbatimit të inovacioneve bashkëkohore në jetën e përditshme, si edhe ndryshimin e rolit të institucioneve tradicionale arsimore.

Arsimi në shekullin XXI ka përcaktuar detyra shumë të ndryshme në krahasim me modelin tradicional të arsimit ku memorizimi i informacioneve dhe të dhënave është pjesa më e rëndësishme e arsimit. Përveç që duhet të bëhet një lidhje e drejtë e inovacioneve me lëndën dhe përmbajtjen mësimore, mësuesit duhet të synojnë përmirësimin e aftësive të tyre për të vënë të gjitha këto njohuri në praktikë duke u bërë më të aftë në mësimdhënie. Kjo mund të arrihet duke pasur një qëndrim të guximshëm dhe eksplorues në drejtim të mësimdhënies, e cila përfshinë përpjekjen për vënie në jetë të metodave të ndryshme, teknikave dhe aktiviteteve tjera, duke reflektuar mbi efektivitetin e tyre dhe duke u bërë të zotët e këtyre përvojave.

Përpjekja për të zhvilluar ide të reja në klasë, ka dobi shtesë për të bërë aktivitetin e mësimdhënies shumë më interesante. Prandaj, duhet përcjellë me kujdes reagimet e nxënësve, të cilat mund të jenë shumë të vlefshme dhe në disa raste apo në situata të reja mund edhe t'i ndihmojnë mësimdhënësit e tyre.

Për më tepër, mësuesit nuk guxojnë të ndjehen të dekurajuar kur përballesh me sfida të reja, të cilat në fillim mund të duken të pakapërcyeshme. Andaj, për t'u nxjerrë nga këto situata, gjithsesi ata duhet të përdorin aktivitete të ndryshme fillestare ose gjëra që e tërheqin vëmendjen e nxënësve, me qëllim që t'i stimuloni ata për temën të cilën duhet ta përpunoni, duke theksuar pse një gjë e tillë është e rëndësishme për ta dhe si do të jetë e dobishme kjo në jetën e tyre.

Krijimi i besimit në aftësitë inovative të mësimdhënies dhe zhvillimi i këtyre aftësive në mënyrë të vazhdueshme nuk është vetëm sfida e mësimdhënësve të rinj. Por, këtë shqetësim e kanë edhe mësimdhënësit me përvojë, kur ata kanë para vetes sfida të reja, të cilat duket se i kërcënojnë vlerat e tyre kohë të gjatë dhe besimin në lidhje me mësimdhënien, sidomos nëse kjo nënkupton ndryshime në praktikën e mësimdhënies.

Nxënësit kanë mundësi ta kuptojnë aspektin teorik të proceseve teknologjike moderne, e njëkohësisht të njihen me aspektin praktik të tyre përmes pajisjeve më të avancuara teknologjike. Zbatimi i inovacioneve, ndihmon nxënësit që të nxitin aftësitë, për të perceptuar rrethin dhe veten, të shprehin dhe të komunikojnë, të jenë të aftë në përdorimin e veglave dhe pajisjeve etj.

Përmes inovacioneve mësimore, nxënësit mund t'i zhvillojnë qëndrimet e mëposhtme: Të kenë mendje të hapur, të kenë shumë zgjidhje para vetes, bëhen më këmbëngulës, bëjnë pyetje më shumë, janë më të vendosur, fitojnë shprehje dhe shkathtësi bashkëpunuese, bëjnë kompromis, po ashtu tregohet një aktivitet praktik që ndihmon zhvillimin e aftësive të bashkëpunimit.

Qasja e re e mësimdhënies përmes aktiviteteve praktike ndihmon që nxënësit t'i zhvillojnë shkathtësitë për jetë dhe punë.

Nevoja për të hulumtuar dhe ndryshuar gjendjen reale në arsim, në kuadër të sistemit tonë arsimor, vazhdimisht është në lidhje të ngushtë me tendencat që të përparohet arsimi fillor tek ne. Andaj, për këtë arsye, duhet që vazhdimisht të nxjerrim konkludime të reja lidhur me përparimin e arsimit.

Nga të dhënat e grumbulluara gjatë hulumtimit të bërë, na lë të kuptojmë se përpos aktorëve tjerë, edhe nxënësit janë të mendimit se në shkollë, patjetër duhet të bëhen ndryshime, nga të cilat ndryshime do të ketë interes shoqëria e së ardhmes.

Nga këto të dhëna, mund të kuptojmë se shumica e nxënësve, rreth përballjes me inovacione në shkollën e tyre, pothuajse kanë dhënë të njëjtin mendim duke deklaruar se në shkollën e tyre, kanë rastin që të përballesh mjaft shpesh me inovacione mësimore.

Ndërsa, nga qëndrimet përgjithshme të nxënësve lidhur me kërkesat apo nevojat e tyre rreth inovacioneve mësimore në shkollën e tyre, një pjesë e madhe e tyre janë deklaruar që shkolla e tyre gjithsesi ka nevojë që të ketë më tepër inovacione mësimore, edhe pse pjesa tjetër ishin si të dyshimtë, ngase mendojnë se shkolla e tyre është mjaft e pasur me inovacione mësimore.

Nga qëndrimet e shumicës së nxënësve, vërehet qartë se inovacionet ndikojnë mjaftueshëm në pasurimin e tyre me njohuri të reja mësimore, ngase ata në shumicën e rasteve janë në pritje të ndryshimeve që duhet ndodhin në shkollën e tyre. Për pos kësaj, shihet se shumica absolute e nxënësve kanë deklaruar se inovacionet mësimore zgjojnë interesim mjaft të madh tek nxënësit për ta dashur jo vetëm shkollën, por gjithçka që ka të bëjë brenda dhe jashtë saj.

Nga këto qëndrime të nxënësve lidhur me inovacionet mësimore si pjesë përbërëse e shkollës, shumica nxënësve janë të mendimit se ato patjetër duhet të jenë pjesë e pa ndashme e shkollës së tyre.

Nga 50 nxënës të anketuar, pothuajse kanë dhënë mendime të shumta dhe të ndryshme lidhur me reagimet e tyre në momente kur përballen dhe në momente kur nuk përballen me inovacione mësimore. Andaj, nga qëndrimet e nxënësve, kemi mundur të kuptojmë se në situata kur përballen ata me inovacione mësimore, janë më të relaksuar, shkëmbejnë ide të lira mes vete, janë më aktiv në shkollë, ndihen më të sigurt dhe më gazmorë, bashkëpunojnë në zgjidhjen e problemeve etj. Kurse, në situata kur nxënësit nuk përballen me inovacione mësimore, nuk e kanë vullnetin e mirëfilltë për të shkuar në shkollë, ndiejnë lodhje psiko-fizike, nuk janë të koncentruar sa duhet tek mësimdhënësi, ora mësimore ju duket shumë e gjatë, me padurim presin të bie zilja etj.

Nga këto të dhëna të përgjithshme, na lë të kuptojmë se reagimet e nxënësve janë mjaft pozitive në momente kur në shkollën apo klasat e tyre përballen me inovacione mësimore.

Rekomandime

Në bazë të analizave përfundimtare të këtij hulumtimi, jemi të obliguar t'u propozojmë disa nga masat që mendojmë se duhet drejtuar mësimdhënësve dhe institucioneve arsimore. Nga rezultatet e këtij hulumtimi kemi nxjerrë këto rekomandime:

Të harmonizohen inovacionet mësimore në raport me përmbajtjet mësimore duke krijuar një mjedis më të gjallë dhe të larmishëm në klasë për të qenë ora mësimore sa më tërheqëse për nxënësit.

Krahas angazhimeve tjera të mësimdhënësve në klasë, gjithsesi duhet plotësuar atë zbrazëtirë edhe me mjete inovative.

Shkolla e së ardhmes patjetër llogaritet të jetë e pasur me inovacione mësimore.

Sipas nevojës dhe kërkesave të kohës, patjetër duhet të implementohen inovacionet mësimore në shkollë dhe klasë nga të gjithë aktorët e arsimit.

Të pasurohen shkollat me teknika dhe teknologji të reja mësimore, që ofrojnë edhe rrjetin global-internetin, për të arritur sa më shpejt deri tek informacioni i ri.

Bibliografia

- Andrić, V., & Čudina, M. (1991). Psihologija učenja i nastave, Školska knjiga, Zagreb.
- Bannur, V. (2000): *Uloga nastavnika u malim i akcionim istraživanjima*, Banja Luka.
- Bekteshi, Dr. Bektesh, (2009). Mbingarkimi i nxënësve me mësim në shkollë, Grafoprint, Prishtinë.
- Bogićević, Mladen, (1974). Tehnologija savremene nastave, Prosveta, Beograd.
- Brada, Dr. Riza. (2010). Didaktika kibernetike, Dukagjini, Prishtinë.
- Djordjević, Dr. Jovan, (1987). Savremena nastava i kompjuteri, Nastava i vaspitanje, Beograd.
- Fullan, Majkell, (2010). Kuptimi i ri i ndryshimit në arsim, Qendra për arsim demokratik, Tiranë.
- Juniku, Dr. Neki, (1997). Modifikimi i sjelljes në shkollë, ETTMK, Prishtinë.
- Karpati, Dr. Andrea, & Mollnar, Dr. Gjengjiver, (2010). Škola budućnosti, Cigoja, Beograd.
- Mandić, D. (2001). Information technology in education, Sarajevo.
- Mandić, D. (2003). Didactical and computer supported innovations in education, Beograd.
- Mandić, Dr. Petar, (1985). Novacionet në mësim, ETMM, Prishtinë.
- Mandić, D. (2010): Knowledge Based Multimedia System for Teacher's Education, in the book 9 th WSEAS International Conference. on Artificial Intelligence, Knowledge Engineering and data bases (AIKED '10), University of Cambridge, Cambridge, United Kingdom, 2010, pp.221-226.
- Mandić, D., Lalic, N., & Bandjur, V. (2010): Managing Innovations in Education, in the book 9 th WSEAS International Conference. on Artificial Intelligence, Knowledge Engineering and data bases (AIKED '10), University of Cambridge, Cambridge, United Kingdom, 2010, pp.231-237.
- Mandić, D., & Ristic, M. (2006): *Web portali i obrazovanja na daljinu u funkciji podizanja kvaliteta nastave*, Merlin, Beograd.
- Mirčeta, Danilović, (1996). Savremena obrazovna tehnologija, Beograd.
- Miroslava, Ristić, (2000). obrazovanje na dalin putem interneta, inovacije u nastavu, nr. 3, Beograd.
- Musai, Bardhyl, (2008). Mësimdhënia dhe të nxënësit ndërveprues, Qendra për arsim demokratik, Tiranë.
- Polak, Vladimir, (1984). Didaktičke inovacije i pedagoške reforma škole, Školska knjiga, Zagreb.
- Šoljan, Nikola, (1976). Tehnologija obrazovanja, Školska knjiga, Zagreb.
- Vilotijević, Goran, (2000). Kako odabrati informacije sa elektroničke mreže, nr. 3,

ROLI I ZHVILLIMIT TË VAZHDUESHËM PROFESIONAL NË KUJDESIN SHËNDETËSOR NË KOSOVË

NIMAN BARDHI

Doktorant në UET – Drejtimi Psikologji

EGLANTINA KRAJA

Doktorante në UET – Drejtimi Psikologji

ABSTRAKT

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional (ZHVP) është një proces i cili përfshin definimin e kritereve, vlerësimin e punës dhe implementimin e ndryshimeve. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte vlerësimi i opinionëve të profesionistëve shëndetësor lidhur me rolin e ZHVP në fuqizimin e kujdesit shëndetësor në Kosovë, si dhe analizimi i nevojave rreth forcimit të bashkëpunimit në sektorin e shëndetësisë.

Hulumtimi është realizuar gjatë periudhës Qershor – Dhjetor 2014, në Prishtinë, Gjakovë dhe Gjiilan, ku janë intervistuar 168 profesionistë nga tri nivelet e kujdesit shëndetësor. Rezultatet në këtë studim pasqyrojnë se në institucionet tona shëndetësore në rend të parë radhitet shfrytëzimi i fuqisë personale (mënyra 5 dhe 11) me 989 pikë, në vend të dytë radhitet ekspertiza profesionale (mënyra 4 dhe 10) me 898 pikë, ndërsa si faktorë i tretë radhitet shpërblymimi i profesionistëve (mënyra 3 dhe 9) me 856 pikë. Gjetjet në këtë studim shohin si pikë të ndjeshme lidhjet, detyrimin dhe rolin-pozitën e profesionistit.

Konkluzione: zbatimi i ZHVP dhe forcimi i bashkëpunimit kolegjal ndihmon në identifikimin e problemeve të shumta që lidhen me fushën profesionale – kujdesin shëndetësor. Bazuar në gjetjet e këtij hulumtimi, i propozohet stafit menaxherial në nivelin qendror dhe atij lokal shëndetësor në: Forcimin e bashkëpunimit dhe zbatimin e ZHVP; Implementimin e standardeve dhe ligjit shëndetësor; Ngritjen e mekanizmave të posaçëm për minimizimin e rreziqeve dhe gabimeve profesionale; Respektimin e statusit të profesionistit dhe rritjen e pagës; Menaxhimin e burimeve njerëzore dhe mjedisit punues; Rishqyrtimin e rolit, pozitës dhe efikasitetit të menaxherit/punonjësit shëndetësor.

Fjalë kyç: ZHVP, profesionistët shëndetësor, institucionet shëndetësore, kujdesi shëndetësor

Hyrje

Nisur nga situata aktuale që ka Kosova, shëndetësia ngelet pika kyçe që kërkon ndërhyrje. Edhe pse janë bërë përpertime të konsiderueshme në shëndetësi, aktualja vazhdimisht po përvidhet, dhe nëse nuk duam që gjithmonë të ngecim pas kohës, atëherë duhet ta parashohim të ardhmen.

Mjekësia në shek. XXI po zhvillohet me një ritëm të shpejtë dhe është vështirë të parashihet si do të ushtrohet ajo nga profesionistët shëndetësor duke marrë parasysh pamundësitë e tyre mbi parashikimin e të ardhmes. Çfarëdo ndryshimesh që të paraqiten në mjekësi si rezultat i zhvillimit shkencor dhe shoqëror, faktorëve politikë dhe ekonomikë, gjithmonë do të ketë njerëz të sëmurë, të cilëve gjithmonë do t'u duhet mjekim dhe kujdes. Profesionistët shëndetësor tradicionalisht i kanë dhënë këto shërbime, bashkë me shërbimet e tjera siç janë përmirësimi i shëndetit, parandalimi i sëmundjes dhe menaxhimi i sistemit shëndetësor.

Ekziston nevoja që të fuqizohet dhe vazhdohet bashkëpunimi me të gjitha subjektet relevante për përmirësimin e shërbimeve në kujdesin shëndetësor në Kosovë. Ngritjet profesionale, të menduarit kritik dhe aftësia për të zgjidhur problemet janë qëllim në procesin e sotëm të edukimit dhe arsimit. Thelbi është: të shndërrojmë mjediset punuese në nivele të duhura, ku në vend të dhënies së informacionit, të kultivohen shprehitë për gjetjen, kërkimin e pavarur, diskutimin e çështjeve në këndvështrime të ndryshme, analizimin, identifikimin e problemeve, me qëllim që të punohet bashkërisht për zgjidhjen e tyre.

Studimi ka për qëllim vlerësimin e opinioneve të profesionistëve shëndetësor lidhur me rolin e Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional (ZHVP) në fuqizimin e kujdesit shëndetësor në Kosovë, si dhe analizimin e nevojave rreth forcimit të bashkëpunimit në sektorin e shëndetësisë.

Të informohen profesionistët shëndetësor që ZHVP i referohet aktiviteteteve mësimore të vetëdrejtuar dhe të bazuara në praktikë, synim ky në ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave (njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet) dhe organizimin e mirëfillte të punës (ndërtimi i ekipit, udhëheqja dhe menaxhimi) në sistemin shëndetësor.

Ky studim mund të jetë një faktor nxitës për zhvillimin dhe identifikimin e pikëpamjeve lidhur me edukimin, bashkëpunimin dhe nevojat në shëndetësi. Këto pikëpamje mund të ndihmojnë në përcaktimin e prioritetëve shëndetësorë, duke identifikuar në mënyrë efektive përmes intervistave me profesionistët shëndetësor në njërin anë, dhe me pacientë/individ në anën tjetër.

Shqyrtimi i problemit

Sipas publikimeve nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë – Departamenti i Statistikës Shëndetësore në Prishtinë, mbi kuadrin në shëndetësinë e Kosovës (Sektori Publik) për 30 komuna, sipas gjendjes të publikuar në Seria Statistikat Sociale – Statistikat e Shëndetësisë 2011, Kosova ka gjithsej të 13.573 të punësuar: mjek = 2546 (18.75%); stomatolog = 366 (2.69%); farmacist = 30 (0.22%); fizioterapist = 14 (0.10%); infermier = 7155 (52.71%); bashkëpunëtor shëndetësor = 96 (0.70%) dhe jomedicinal = 3.366 (24.79%). Në kudër të të dhënave të prezantuara më lartë mungon kuadri i institutive paraklinike, kuadri i institucioneve private dhe kuadri i 6 komunave me komunitetin serb.

Bazuar nga takimet punuese duhet që të gjithë profesionistët shëndetësorë të kenë ngritje profesionale, me qëllim të fuqizimit të rolit dhe efikasitetit të tyre gjatë praktikimit të shkathtësive të nevojshme në trajtimin e të sëmurit dhe të plotësimin të kriterit të Strategjisë Sektoriale Shëndetësore të Kosovës, për funksionimin e mirëfilltë të profesionistit shëndetësor.

Duhet përmendur edhe aktivitetet e tjera si rehabilitimin dhe rregullimin e ambienteve dhe objekteve shëndetësore, aplikimin e metodave të reja menaxhuese, edukimin profesional për profesionistë shëndetësor, sigurimin e mjeteve bashkëkohore didaktike dhe të literaturës bashkëkohore shkencore, rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit në mes të profesionistëve në tri nivelet e kujdesit shëndetësor.

Roli i ZHVP në kujdesin shëndetësor në Kosovë

ZHVP është një proces i cili përfshin definimin e kriterëve, vlerësimin e punës dhe implementimin e ndryshimeve. Ai përqendrohet në ndryshime dhe kryesisht përdor metoda të ardhshme dhe të mundshme. Në këtë kontekst përfshinë "Ekipin". ZHVP fillon pas përfundimit të edukimit themelor dhe trajnimit specialistik. ZHVP qëndron si imperativ profesional i secilit profesionist shëndetësor dhe njëkohësisht është edhe parakusht për përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor.

ZHVP nënkupton aktivitetet mësimore të vetëdrejtuar dhe të bazuara në praktikë, dhe jo trajnimin e mbikëqyrtur. Përveç që ndihmon zhvillimin personal profesional, ZHVP synon ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave (njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet) dhe organizimin e punës (ndërtimi i ekipit, udhëheqja dhe menaxhimi).

Vendosja e një sistemi të ZHVP që bazohet në nevoja, do të identifikonte zbrazëtitat në ofrimin e edukimit dhe do t'u mundësonte personave përgjegjës për edukimin që të organizojnë kurse të tilla që t'i përbushin ato nevoja. Kështu, ZHVP do të bëhej kuptimplotë dhe relevant për kujdesin për pacientë.

Vlerësimi i nevojave duhet të jetë pika fillestare e ZHVP. Megjithatë, nevojat dallojnë nga institucioni në institucion dhe nga një profesionist në tjetrin. Dhe, pasi relevanca është faktor vendimtar në suksesin e edukimit të të rriturve, mund të konkludohet se përvoja më e mirë e të mësuarit do të duhej të bazohej në institucionin shëndetësor, ose së paku të bazohej në përvojën e institucionit shëndetësor.

Ashtu siç është i rëndësishëm vlerësimi i nevojave mësimore për të siguruar mjetet e nevojshme për plotësimin e atyre nevojave, është gjithashtu i rëndësishëm vlerësimi i ndryshimit të kompetencave si rezultat i ZHVP dhe i asaj se si pacientët dhe komuniteti përfitojnë nga përmirësimi i sjelljes së profesionistit shëndetësor dhe ekipit në tërësi.

Bazuar në këtë, ekzistojnë tri (3) burime të ndryshme prej të cilave profesionistët shëndetësor mund të zhvillohen, në

Fushën profesionale – aktivitetet që lidhen me punën e përditshme (pjesëmarrja në vizitat dhe diskutimet javore në institucion, në zhvillimin e udhëzuesve ose protokolleve të rinjtë, në aktivitetet trajnuese, në vlerësimin klinik retrospektiv).

Fushën hulumtuese – aktivitetet që i sjellin informacione të reja komunitetit shkencor (pjesëmarrja në projekt hulumtues, publikimi i ndonjë artikulli shkencor, etj.).

Fushën akademike – aktivitetet që kenë ndërmarrë për promovimin e mësimi të të tjerëve (ligjërimi, lehtësimi, mentorimi, botimi apo recensimi i një libri, shkrimi i një kapitulli të një libri, doktoratura ose magjistratura, etj).

Vlerësimi i ZHVP dhe bashkëpunimi ndërkolegjial dhe ndërinstitutional arrihet përmes matjes objektive të ndryshimit të sjelljes, që shërben si një element i rëndësishëm i ZHVP dhe tërheqjen e “pikëve” kredituese. Auditit klinik është një element i rëndësishëm si një matje objektive e nevojës, si dhe vlerësim të rezultateve në ZHVP.

E ardhmja për kujdesin shëndetësor në Kosovë është të mësuarit si ekip, duke u bazuar në nevojat e klientëve/pacientëve që identifikohen nga vetë ekipi. Pjesë përbërëse e kësaj do të jenë edhe nevojat profesionale ose personale të profesionistëve shëndetësor, të cilët duhet të kenë një strukturë të thjeshtë brenda së cilës do të planifikonin nevojat e tyre profesionale.

Ç’do profesionist shëndetësor do të duhej të mbante një ditar reflektiv, që do të ishte i dobishëm kryesisht për vetë atë, por që do të ndahej edhe me një mbikëqyrës/mentor mësimor, si dhe të diskutohej brenda një grupi kolegësh. Ky ditar do të përdoret si dëshmi e ZHVP për revalidimin. Sigurimi i cilësisë mund të kryhet si ekstern (nga krijuesit e politikave, siguruesit, pacientët apo bordet e jashtme) apo intern (nga vetë profesionistët). Mund të synohet drejt zgjedhjes dhe kontrollit (p.sh. rilicencimi, akreditimi dhe buxheti), gjithashtu mund të jetë edukativ, i përqendruar në procesin e mësimi dhe përparimit të profesionistëve shëndetësor dhe praktikave të tyre.

Dihet që ofruesit e kujdesit shëndetësor kanë tendencë të theksojnë qëllimet “edukative”, derisa përpiluesit e politikave, në përgjithësi përqendrohen në qëllime diskrete ku arrijtjet mund të maten. Që të fillohet me sukses bashkëpunimi koledjal dhe të vazhdojë rrjedhshëm, nuk mjaftojnë vetëm: programi i mirë, udhërrëfyesit i pranueshëm dhe instrumenta të leverdishme të vlerësimit, por duhen përmëshur kushte të caktuara që procesi i punës të bëhet një përvojë e frytshme dhe e vlefshme për pjesëmarrësit. Këto kushte merren me:

Informimin dhe përgatitjen e kolegëve/institucionin,
Karakteristikat e grupeve për bashkëpunim koledjal,
Parakushtet strukturale dhe organizative.

Nisur nga elementet e lartëcekura, detyrë me rëndësi është aktiviteti/programi për ZHVP, që duhet të jetë i dizajnuar ashtu që të punohet gradualisht drejt rritjes së përvojës dhe metodologjisë, drejt ndryshimit dhe përparimit në praktikë dhe autonomisë së grupit, gjithnjë duke u bazuar në Kodin Etik.

Parimet etike, siç janë respekti, pëlqimi, dhe mirëbesimi janë baza e marrëdhënieve ndërkoledjiale. Pothuajse në tërë historinë e shkruar dhe në të vërtetë në çdo pjesë të botës, të jesh profesionist shëndetësor si: mjek, stomatolog, infermier, mami, etj., do të thotë diçka e veçantë. Ngritja dhe zhvillimi i personelit shëndetësor që fokusohen në karakteristikat profesionale, shpesh ndihmon zhvillimin personal dhe veprimet në dobi të pacientit dhe vetë institucionit. Kërkimet e pavarura, diskutimet e çështjeve në këndvështrime të ndryshme, analizimi i tyre, identifikimi i problemeve, komunikimi dhe dialogu janë qëllim që të punohet bashkërisht në grupe dhe në njohjen e përafërt të rolit të profesionistit shëndetësor.

Qëllimi

Qëllimi i studimit ishte vlerësimi i opinioneve të profesionistëve shëndetësor lidhur me rolin e ZHVP në fuqizimin e kujdesit shëndetësor në Kosovë, si dhe analizimi i nevojave rreth forcimit të bashkëpunimit në sektorin e shëndetësisë.

Objektivat

Objektivi i përgjithshëm i këtij studimi është njohja dhe analizimi i nevojave për ZHVP si faktor në forcimin e bashkëpunimit në mes tri niveleve të kujdesit shëndetësor në Kosovë, si dhe:

Vlerësimi i nevojave dhe ndërhyrjet përmes aktiviteteve edukative/arsimore.
Shqyrtimi i shkathtësive komunikuese koledjiale dhe ndërkoledjiale.
Vlerësimi në mënyrë kritike i situatës aktuale dhe ndikimi tek të tjerët për ndryshime.

Pyetjet hulumtuese

Ishin orientuar në dy drejtime:

Cilat janë opinionet e profesionistëve shëndetësorë lidhur me ZHVP dhe bashkëpunimin kolegjal në tri nivelet e kujdesit shëndetësor në Kosovë?

Përmes cilave mënyra mund të influencohet tek njerëzit dhe ngjarjet në përmirësimin dhe forcimin e bashkëpunimit?

Metodologjia

Studimi rezulton me mbledhjen e të dhënave sistematike në mënyrë numerike, duke bërë analizimin dhe ekzaminimin real të rrethanave në të cilën ndodhen profesionistët shëndetësorë dhe duke dhënë opinionet e tyre lidhur me mjedisin punues. Statistikat deskriptive (përqindjet, mesataret, etj.) janë përdorur për përshkrimin e situatës aktuale, duke përshkruar konceptet dhe identifikimet si bazë për këtë hulumtim kuantitativ. Statistikat deskriptive në këtë studim identifikohen qartë në: qëllimin, pyetjen hulumtuese, analizën e të dhënave dhe gjetjet.

Të dhënat janë mbledhur me ndihmën e listës evidentuese dhe pyetësorëve anonim të strukturuar me pyetje të hapura për zhvillimin evolues të profesionistëve shëndetësorë.

Studimi bazohet në grumbullimin e të dhënave numerike nga gjithsej të 168 profesionistë shëndetësor, përdorur pyetësorët evolues i kanë plotësuar 138 (82.1%) prej tyre. Studimi është realizuar gjatë periudhës Qershor - Dhjetor 2014.

Procedurat e aplikuara për zgjedhjen e mostrave janë të shumëllojshme, që përfshijnë: mjekë, infermierë, mami dhe profesionistë të tjerë shëndetësor nga institucione të ndryshme shëndetësore. Me qëllim të përfaqësimit të një numri adekuat të personelit shëndetësor në këtë studim, është bërë ndarja në tri qendra regjionale: Prishtinë, Gjilan dhe Gjakovë (shih tab.nr.1), duke u bazuar në dy kritere kryesore:

Qasja e profesionistëve shëndetësorë (selektimi është përcaktuar sipas përqindjes së profesionistëve që kanë sistemet shëndetësore, bazuar në strategjinë shëndetësore),

Përfaqësimi i tri niveleve shëndetësore - regjionale.

TABELA NR. 1: Pjesëmarrësit regjional dhe vendi i takimit punues dhe evaluës

Nr.	Pjesëmarrësit nga regionet	Vendi i takimit / evoluimit
1.	Prishtinë, Besianë, F. Kosovë, Lipjan, Shtime, Kastriot, Drenas, Mitrovicë, Vushtri, Skenderaj	Prishtinë – QKUK
2.	Gjilan, Ferizaj, Dardanë, Kaçanik, Viti	Gjilan - Spitali Regjional
3.	Gjakovë, Prizren, Pejë, Malishevë, Therandë, Rahovec, Sharr, Deçan, Klinë, Burim	Gjakovë – QKMF

Procedura e mbledhjes së të dhënave është relevante dhe e përpiktë përmes matjeve së variablave të shprehjes numerike për të paraqitur sasinë dhe diferencën. Të gjitha të dhënat e grumbulluara janë analizuar në tërësi, duke ruajtur besueshmërinë absolute, gjithnjë duke u bazuar në parimet etike.

Rezultatet

Bazohen në tri instrumentet matës, si: lista e evidentimit (instrumenti 1); mënyrat të cilat mund të influencohet tek njerëzit dhe ngjarjet (instrumenti 2) dhe evoluimin në formë të shkruar (instrumenti 3).

Instrumenti 1

Në përpilimin e listës së evidentimit janë kërkuar të dhënat për moshën, gjininë, regjionin, titullin, vend punimin. Në këtë studim kanë marrë pjesë dhe janë evidentuar gjithsej të 168 pjesëmarrës, që përfaqësonin kujdesin parësor, dytësor dhe tretësor shëndetësor. Përzgjedhja e tyre në pjesëmarrje ishte përcaktuar nga vetë institucionet shëndetësore. Duhet theksuar se në tri regjionet ku janë mbajtur takimet punuese dhe evoluese, pjesëmarrësit ishin edhe të regjioneve të tjera, arsyeja ishte që të mbulohen të gjitha nivelet regjionale me qëllim të identifikimit, analizimit dhe përshkrimit të gjendjes aktuale bashkëpunuese në nivel të sistemeve shëndetësore. (shih tab.nr.1)

Numri i pjesëmarrësve sipas regjioneve që kanë marrë pjesë gjatë këtij studimi, ishte: në takimin e parë në Prishtinë = 46 (27.4%) pjesëmarrës, në takimin e dytë në Gjilan = 59 (35.1%) pjesëmarrës, dhe në takimin e tretë në Gjakovë = 63 (37.5%) pjesëmarrës, të gjithë profesionistë shëndetësor.

Numrin e përgjithshëm i përfaqësuesve sipas niveleve të kujdesit shëndetësor në tri takimet punuese – evoluese, ishte: nga KPSH 80 (47.5%) pjesëmarrës; nga KDSH 58 (34.6%) pjesëmarrës dhe nga KTSH 30 (17.9%) pjesëmarrës. (shih tab.nr.2):

TABELA NR. 2: NUMRI I PËRGJITHSHËM I PËRFAQËSUESVE SIPAS NIVELEVE SHËNDETËSORE

Regjioni	KPSH		KDSH		KTSH		Gjithsej të:	
	f	%	F	%	f	%	f	%
Prishtinë	16	9.5	8	4.8	22	13.1	46	27.4
Gjilan	29	17.2	25	14.9	5	3.0	59	35.1
Gjakovë	35	20.8	25	14.9	3	1.8	63	37.5
Gjithsej të:	80	47.5	58	34.6	30	17.9	168	100

Pjesëmarrës në këtë studim ishin 139 (82.7%) femra dhe 29 (17.3%) meshkuj.

Grup moshë e pjesëmarrësve ishte: prej 17 – 26 vjeç ishin 31 (18.5%) pjesëmarrës, 40 (23.8%) pjesëmarrës ishin të moshës prej 27 – 36 vjeç, prej 37 – 46 vjeç ishin 67 (39.9%) pjesëmarrës, 28 (16.6%) pjesëmarrës ishin prej moshës 47 – 56 vjeç dhe vetëm 2 (1.2%) pjesëmarrës ishin të grup moshës 57 – 66 vjeç.

Pjesëmarrësit në studim ishin profesionistë të fushave dhe me thirrje/gradime të ndryshme, si: profesor, specialist, mjek, stomatolog, farmacist, fizioterapist, infermier, mami, laborant, anesteziist, student si dhe menaxher të institucioneve/shërbimeve: drejtor, kryeshef, koordinator, dhe trajner. Të gjithë pjesëmarrësit ishin të profileve dhe vendpunimeve të ndryshme institucionale, si nga: QKUK, Spitalet Regionale, QKMF, QMF, QSHMK, IMP, Enti Special në Shtime, Shtëpia e Pleqëve në Prishtinë dhe Qendra e Mirëqenies së Gruas në Gjilan.

Instrumenti 2

Ky pyetësor kishte për qëllim mënyrat e shfrytëzimit të fuqisë duke ndihmuar në vlerësimin se si përdoret fuqia në vendin e punës. Pyetësori ishte anonim dhe është plotësuar nga 138 pjesëmarrës. Për secilën pyetje të prezantuar në pyetësor, pjesëmarrësit kanë përcaktuar me pikë mënyrën varësisht se si e kanë përdorur atë (1=pak; 2=nganjëherë; 3=zakonisht, 4=gjithmonë).

Opinionet e profesionistëve lidhur me shfrytëzimin e fuqisë dhe pozitës në institucion

46 (33.3%) pjesëmarrës deklaruan gjithmonë, 41 (29.8%) zakonisht, 38 (27.5%) nganjëherë dhe 13 (9.4%) pjesëmarrës deklaruan se e shfrytëzojnë pak fuqinë dhe pozitën formale në institucion.

Opinionet e profesionistëve lidhur me paralajmërimin rreth pasojave për veprime të caktuara që nuk më pëlqejnë

38 (27.5%) pjesëmarrës janë deklaruar gjithmonë, 32 (23.2%) pjesëmarrës janë deklaruar zakonisht, 52 (37.7%) pjesëmarrës nganjëherë dhe 16 (11.6%) pjesëmarrës janë deklaruar se pak paralajmërojnë rreth pasojave për veprime të caktuara që nuk ju pëlqejnë.

Opinionet e profesionistëve lidhur me lavdërimin e njerëzve dhe vlerësimin e kontributeve të tyre

63 (45.7%) pjesëmarrës janë deklaruar gjithmonë, 36 (26.1%) pjesëmarrës janë deklaruar zakonisht, 26 (18.8%) pjesëmarrës nganjëherë dhe 13 (9.4%) pjesëmarrës janë deklaruar se e bëjnë pak lavdërimin e njerëzve dhe vlerësimin e kontributeve të tyre.

Opinionet e profesionistëve lidhur me mbështetjen në njohuritë dhe ekspertizën specialiste

68 (49.3%) pjesëmarrës janë deklaruar gjithmonë, 33 (23.9%) pjesëmarrës janë deklaruar zakonisht, 21 (15.2%) pjesëmarrës nganjëherë dhe 16 (11.6%) pjesëmarrës janë deklaruar se mbështeten pak në njohuritë dhe ekspertizën specialiste.

Opinionet e profesionistëve lidhur me bashkëpunimin e mirë me njerëzit që më pëlqejnë

91 (66%) pjesëmarrës janë deklaruar gjithmonë, 38 (27.5%) pjesëmarrës janë deklaruar zakonisht, 8 (5.8%) pjesëmarrës nganjëherë dhe 1 (0.7%) pjesëmarrës janë deklaruar se pak bashkëpunojnë mirë me njerëzit që ju pëlqejnë.

Opinionet e profesionistëve lidhur me lidhjet e njerëzve me burimet tjera të të dhënave dhe resurseve

30 (21.7%) pjesëmarrës janë deklaruar gjithmonë, 48 (34.8%) pjesëmarrës janë deklaruar zakonisht, 34 (24.7%) pjesëmarrës nganjëherë dhe 26 (18.8%) pjesëmarrës janë deklaruar se e shfrytëzojnë pak lidhjen e njerëzve me burimet tjera të të dhënave dhe resurseve.

Opinionet e profesionistëve lidhur me të qenit në pozitë të lartë brenda institucionit

25 (18.1%) pjesëmarrës janë deklaruar gjithmonë, 30 (21.7%) pjesëmarrës janë deklaruar zakonisht, 48 (34.8%) pjesëmarrës nganjëherë dhe 35 (25.4%) pjesëmarrës janë deklaruar se pak kanë qenë në pozitë të lartë brenda institucionit.

Opinionet e profesionistëve lidhur me sugjerimin për gjërat që mund të vështirësohen për ta nëse shkruajnë një raport të pafavorshëm

33 (23.9%) pjesëmarrës janë deklaruar gjithmonë, 31 (22.4%) pjesëmarrës janë deklaruar zakonisht, 47 (34.1%) pjesëmarrës nganjëherë dhe 27 (19.6%) pjesëmarrës janë deklaruar se pak, mund të vështirësojë situatën për ta nëse shkruajnë një raport të pafavorshëm.

Opinionet e profesionistëve lidhur me ofrimin që duan njerëzit në këmbim të bashkëpunimit të tyre

65 (47.1%) pjesëmarrës janë deklaruar gjithmonë, 38 (27.5%) pjesëmarrës janë deklaruar zakonisht, 22 (16%) pjesëmarrës nganjëherë dhe 13 (9.4%) pjesëmarrës janë deklaruar pak, në ofrimin e asaj që duan njerëzit në këmbim të bashkëpunimit të tyre.

Opinionet e profesionistëve lidhur me kredibilitetin dhe përvojën në këtë fushë

78 (56.5%) pjesëmarrës janë deklaruar gjithmonë, 43 (31.2%) pjesëmarrës janë deklaruar zakonisht, 11 (8%) pjesëmarrës nganjëherë dhe 6 (4.3%) pjesëmarrës janë deklaruar pak, shfrytëzojnë kredibilitetin dhe përvojën në këtë fushë.

Opinionet e profesionistëve lidhur me të mundësuarit që njerëzit të mësojnë dhe reflektojnë nga përvojat e mia personale

99 (71.8%) pjesëmarrës janë deklaruar gjithmonë, 25 (18.1%) pjesëmarrës janë deklaruar zakonisht, 9 (6.5%) pjesëmarrës

nganjëherë dhe 5 (3.6%) pjesëmarrës janë deklaruar pak, mundësojnë që njerëzit të mësojnë dhe reflektojnë nga përvojat e tyre personale. Opinionet e profesionistëve lidhur me sugjerimin për aleanca dhe lidhje me njerëz dhe grupe tjera 72 (52.2%) pjesëmarrës janë deklaruar gjithmonë, 39 (28.3%) pjesëmarrës janë deklaruar zakonisht, 17 (12.3%) pjesëmarrës nganjëherë dhe 10 (7.2%) pjesëmarrës janë deklaruar pak, sugjerojnë për aleanca dhe lidhje me njerëz dhe grupe tjera. Bazuar në të kuptuarit dhe të shfrytëzuarit e fuqisë dhe influencës profesionale në vendin e punës sipas mënyrave të shfrytëzimit të fuqisë, pikët e mbledhura mund të shihen në tabelën nr.3.

TABELA NR. 3. SHFRYTËZIMI I FUQISË


Mënyrat	Pikat e përgjithshme	Burimi i fuqisë
1 dhe 7	717	Roli dhe pozita
2 dhe 8	714	Detyrimi
3 dhe 9	856	Shpërblimi
4 dhe 10	898	Ekspertiza
5 dhe 11	989	Fuqia personale
6 dhe 12	807	Lidhjet

Numri i pikëve të prezantuara nga pjesëmarrësit për pjesët përkatëse të rrethit ku ata punojnë dhe veprojnë, prezantojnë burimet e fuqisë aktuale. Sipas përgjigjeve të marra nga pjesëmarrësit për shfrytëzimin e fuqisë, shihet:

- I. Në pozitë të parë renditet fuqia personale (mënyra 5 dhe 11) me gjithsej 989 pikë, bazuar në bashkëpunimin e mirë me njerëzit duke ju mundësuar atyre që të mësojnë dhe reflektojnë nga përvojat e tyre profesionale.
- Në pozitën e dytë renditet ekspertiza (mënyra 4 dhe 10) me gjithsej 898 pikë, e mbështetur në njohuritë, ekspertizën, kredibilitetin dhe përvojën në punë.
- III. Në pozitën e tretë renditet shpërblimi (mënyra 3 dhe 9) me gjithsej 856 pikë, i bazuar në lavdëratat, kontributet dhe favorët e ndryshme që nuk janë të bazuara në profesionalizëm.
- IV. Në pozitën e katërt renditen lidhjet (mënyra 6 dhe 12) me gjithsej 807 pikë, duke u bazuar dhe shfrytëzuar lidhjet e njerëzve dhe nepotizmin.
- Në pozitën e pestë renditet roli dhe pozita (mënyra 1 dhe 7) me gjithsej 717 pikë. Kjo pasqyron shfrytëzimin e fuqisë dhe pozitës së lartë brenda institucionit.
- VI. Në pozitën e gjashtë radhitet detyrimi (mënyra 2 dhe 8) me gjithsej të 714 pikë, bazuar në kërcënimet për veprimet e caktuara si dhe sugjerimi që gjërat mund të vështirësohen nëse shkruhet një raport i pa favorshëm.

Duke analizuar të dhënat e fituara (Grafikoni nr.1), rezultati i këtij studimi pasqyron faktin se në vendpunimet tona akoma shfrytëzohet fuqia personale (989 pikë). Ekspertiza profesionale radhitet e dyta (898 pikë) që pasqyron mbështetjen në njohuritë, kredibilitetin dhe përvojën në punë. Faktori i tretë ceket shpërblimi (856 pikë).

GRAFIKONI NR.1 – SHFRYTËZIMI I FUQISË



Instrumenti 3

Pyetësori i evoluimit në formë të shkruar kishte për synim satisfaksionin e profesionistëve lidhur me përmbushjen e aktivitetit punues për mësimnxënie, rolin e ZHVP në njërin dhe mjedisi dhe kushtet punuese në anën tjetër. Pyetësori ishte anonim dhe është plotësuar nga 138 pjesëmarrësit në takim. Studimi ka subjekte të ndryshme në lidhje me edukimin, idetë bazë dhe është një udhëzues i mirë për profesionistët shëndetësorë.

Opinionet e profesionistëve lidhur me përmbushjen e synimeve mësimore të përshkruara në aktivitet lidhur me ZHVP? 66 (47.8%) pjesëmarrës deklaruan se aktiviteti i ka plotësuar shumë mirë synimet, 40 (29%) pjesëmarrës deklaruan mirë, 31 (22.5%) deklaruan në nivel adekuat, ndërsa 1 (0.7%) pjesëmarrës deklarohet jo-kënaqshëm është plotësuar synimi gjatë aktivitetit. (Shiko tabelen nr. 4)

TAB. NR.4: PËRMBUSHJA E SYNIMEVE MËSIMORE TË PËRSHKRUARA NË AKTIVITET LIDHUR ME ZHVP

Regjioni	GJINIA																TOTAL (M+F)	
	Prishtinë				Gjilan				Gjakovë				Gjithsej:					
	F		M		F		M		F		M		F		M			
	f	%	f	%	f	%	f	%	f	%	f	%	f	%	f	%		
Shumë mirë	15	10.8	3	2.2	19	13.8	2	1.5	24	17.4	3	2.2	58	42.0	8	5.8	66	47.8
Mirë	10	7.3	1	0.7	17	12.3	3	2.2	7	5.1	2	1.5	34	24.6	6	4.3	40	29.0
Në nivel adekuat	7	5.1	1	0.7	6	4.3	3	2.2	13	9.4	1	0.7	26	18.8	5	3.7	31	22.5
Jo kënaqshëm	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1	0.7	-	-	1	0.7	1	0.7
Dobët	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shumë dobët	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej:	32	23.2	5	3.6	42	30.4	8	5.8	44	31.9	7	5.1	118	85.5	20	14.5	138	100
f (F+M)	37				50				51				138					
% (F+M)	26.8				36.2				37.0				100					
Chi – testi	$X_2 = 0.33, p < 0.56$				$X_2 = 0.17, p < 0.68$				$X_2 = 0.32, p < 0.57$									
Chi – testi (Femra)	$X_2 = 0.83, p < 0.36$																	
Chi – testi (Meshkuj)	$X_2 = 1.79, p < 0.40$																	

Nga të dhënat e analizuar lidhur me përmbushjen e synimeve mësimore sipas gjinisë në të tri regjionet, shihet se nuk ka dallim sinjifikant.

Opinionet e profesionistëve lidhur me satisfaksionin me mjedisin dhe kushtet e punës? (Tabela nr.5)

A jeni të kënaqur me mjedisin e institucionit ku ju punoni?

11 (8%) pjesëmarrës janë deklaruar se aspak nuk janë të kënaqur, 17 (12.3 %) pjesëmarrës pak janë të kënaqur, 64 (46.4 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 46 (33.3%) pjesëmarrës janë shumë të kënaqur, me mjedisin e institucionit ku punojnë.

A jeni të kënaqur me respektimin dhe trajtimin e barabartë në institucionit tuaj?

36 (26.1%) pjesëmarrës janë deklaruar se aspak nuk janë të kënaqur, 38 (27.5 %) pjesëmarrës pak janë të kënaqur, 34 (24.6 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 30 (21.8%) pjesëmarrës deklarohen se janë shumë të kënaqur, në institucionet ku punojnë.

A jeni të kënaqur me nivelin e komunikimit dhe pëlqimin e marrur nga lidhshipi i institucionit tuaj?

36 (26.1%) pjesëmarrës janë deklaruar se aspak nuk janë të kënaqur, 38 (27.5 %) pjesëmarrës pak janë të kënaqur, 34 (24.6 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 30 (21.8 %) pjesëmarrës deklarohen se janë shumë të kënaqur, me nivelin e komunikimit dhe pëlqimit të marrur nga lidhshipi në institucionet ku punojnë.

A jeni të kënaqur me vendimmarrjen në emër të pacienteve të paaftë nga koleget në institucionin tuaj?

44 (31.9%) pjesëmarrës janë deklaruar se aspak nuk janë të kënaqur, 41 (29.7 %) pjesëmarrës pak janë të kënaqur, 39 (28.3%) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 14 (10.1 %) pjesëmarrës deklarohen se janë shumë të kënaqur, me vendimmarrjen në emër të pacientëve të paaftë nga kolegët në institucionet e tyre.

A jeni të kënaqur me mirëbesimin e klientëve/pacienteve ndaj jush?

11 (8%) pjesëmarrës janë deklaruar se aspak nuk janë të kënaqur, 10 (7.2 %) pjesëmarrës pak janë të kënaqur, 85 (61.6 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 32 (23.2%) pjesëmarrës deklarohen se janë shumë të kënaqur, me mirëbesimin e klientëve/pacienteve ndaj tyre.

A jeni të kënaqur me marrëdhëniet e ndërsjella profesionale në mes tri niveleve të kujdesit shëndetësor?

38 (27.5%) pjesëmarrës janë deklaruar se aspak nuk janë të kënaqur, 49 (35.5 %) pjesëmarrës pak janë të kënaqur, 29 (21 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 22 (16%) pjesëmarrës deklarohen se janë shumë të kënaqur me marrëdhëniet e ndërsjella profesionale.

A jeni të kënaqur me raportimet për veprimet e rrezikshme jo etike të bëra në institucionin tuaj?

58 (42%) pjesëmarrës janë deklaruar se aspak nuk janë të kënaqur, 53 (38.4 %) pjesëmarrës pak janë të kënaqur, 16 (11.6 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 11 (8%) pjesëmarrës deklarohen se janë shumë të kënaqur me raportimet për veprimet e rrezikshme jo etike të bëra në institucionin e tyre.

A jeni të kënaqur me bashkëpunimin klient/pacientë – personel shëndetësor?

20 (14.5%) pjesëmarrës janë deklaruar se aspak nuk janë të kënaqur, 17 (12.3 %) pjesëmarrës pak janë të kënaqur, 58 (42 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 43 (31.2%) pjesëmarrës deklarohen se janë shumë të kënaqur, me bashkëpunimin klient/pacientë – personel shëndetësor.

A jeni të kënaqur me insistimin në zgjidhjen e konflikteve në institucionin tuaj?

41 (29.7%) pjesëmarrës janë deklaruar se aspak nuk janë të kënaqur, 40 (29 %) pjesëmarrës pak janë të kënaqur, 43 (31.1 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 14 (10.2%) pjesëmarrës janë shumë të kënaqur, me insistimin në zgjidhjen e konflikteve në institucionin e tyre.

A jeni të kënaqur me përgjegjësitë dhe privilegjet e profesionisteve shëndetësor në institucionin tuaj?

29 (21%) pjesëmarrës janë deklaruar se aspak nuk janë të kënaqur, 39 (28.2 %) pjesëmarrës pak janë të kënaqur, 44 (31.9 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 26 (18.9%) pjesëmarrës deklarohen se janë shumë të kënaqur me përgjegjësitë dhe privilegjet e profesionisteve shëndetësor ne institucionin e tyre.

A jeni të kënaqur me përgjegjësitë ndaj vetvetes?

10 (7.2%) pjesëmarrës janë deklaruar se aspak nuk janë të kënaqur, 12 (8.7 %) pjesëmarrës pak janë të kënaqur, 72 (52.2 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 44 (31.9%) pjesëmarrës deklarohen se janë shumë të kënaqur me përgjegjësitë ndaj vetvetes.

A jeni të kënaqur me vetveten lidhur me realizimin e synimeve tuaja?

5 (3.6%) pjesëmarrës janë deklaruar se aspak nuk janë të kënaqur, 7 (5.1%) pjesëmarrës pak janë të kënaqur, 77 (55.8%) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 49 (35.5%) pjesëmarrës deklarohen se janë shumë të kënaqur me vetveten lidhur me realizimin e synimeve personale.

TABELA NR.5: SATISFAKSIONI ME MJEDISIN DHE KUSHTET E PUNËS

A jeni të kënaqur me:	Aspak i kënaqur		Pak i kënaqur		I kënaqur		Shumë i kënaqur		Totali	
	f	%	f	%	f	%	f	%	f	%
Mjedisin e institucionit ku ju punoni?	11	8	17	12.3	64	46.4	46	33.3	138	100
Respektimin dhe trajtimin e barabartë në institucionin tuaj?	36	26.1	38	27.5	34	24.6	30	21.8	138	100
Nivelin e komunikimit dhe pëlqimin e marrur nga lidhshipi i institucionit tuaj?	36	26.1	38	27.5	34	24.6	30	21.8	138	100
Vendimmarrjen në emër të pacientëve të paaftë nga kolegët në institucionin tuaj?	44	31.9	41	29.7	39	28.3	14	10.1	138	100
Mirëbesimin e klientëve/pacienteve ndaj jush?	11	8	10	7.2	85	61.6	32	23.2	138	100
Marrëdhëniet ndërkolegjiale?	25	18.1	20	14.5	42	30.4	51	37	138	100
Marrëdhëniet e ndërsjella profesionale në mes tri niveleve të kujdesit shëndetësor?	38	27.5	49	35.5	29	21	22	16	138	100
Raportimet për veprimet e rrezikshme jo etike të bëra në institucionin tuaj?	58	42	53	38.4	16	11.6	11	8	138	100
Bashkëpunimin klient/pacientë – personel shëndetësor?	20	14.5	17	12.3	58	42	43	31.2	138	100

Insistimin në zgjidhjen e konflikteve në institucionin tuaj?	41	29.7	40	29	43	31.1	14	10.2	138	100
Përgjegjësitë dhe privilegjet e profesionistëve shëndetësor në institucionin tuaj?	29	21	39	28.2	44	31.9	26	18.9	138	100
Përgjegjësitë ndaj vetvetes?	10	7.2	12	8.7	72	52.2	44	31.9	138	100
Vetveten lidhur me realizimin e synimeve tuaja?	5	3.6	7	5.1	77	55.8	49	35.5	138	100

Nga të dhënat e analizuar lidhur me satisfaksionin me mjedisin dhe kushtet e punës, në të tri regionet, shihet se ka dallim sinjifikant ($X = 37.87$, $p < 0.01$).

Diskutime

Studimi bazohet në grumbullimin e të dhënave numerike nga 168 profesionistë shëndetësor, përderisa pyetësorët evolues që ishin anonim i kanë plotësuar 138 (82.1%) prej tyre.

Bazuar në gjetjet dhe vlerësimet e profesionistëve lidhur me influencimin e tyre tek individët dhe ngjarjet, ishin të ndryshme për pjesët përkatëse të rrethit ku ata punojnë dhe veprojnë. Rezultati i fituar në këtë studim tregon se në vendpunimet tona akoma shfrytëzohet fuqia personale. Ekspertiza profesionale radhitet e dyta dhe tregon mbështetjen në njohuritë, kredibilitetin dhe përvojën në punë. Faktori i tretë është shpërblimi i profesionistëve.

Sipas studimit “Analizimi i sistemit në kujdesin shëndetësor” të realizuar në Qendrën Mjekësore Universitare në Heidelberg të Gjermanisë, intervistat ishin realizuar në 3 departamente nga muaji Tetor-1999 që kanë zgjatur 8 muaj. Në studim janë realizuar nga 60 intervista me profesionistët që kanë punuar në tri departamente: 1) informatikë mjekësore, 2) psikiatri dhe 3) dermatologji. Përgjigjet valide në pyetjet e parashtruara i kanë dhënë mbi 30 (60%) pjesëmarrës nga secili departament. Grup moshat nuk janë cekur në këtë studim.

Nga gjetjet në studimin tim del në pah se pikët më të ndjeshme të hulumtimit janë: detyrimi, roli dhe pozita e profesionistit. Paralajmërimi rreth pasojave dhe sugjerimi i gjërave të shkruara në raport shpesh mund të konsiderohen si i pafavorshëm, andaj roli dhe të qenit në pozitë të lartë brenda organizatës nuk mund të jetë mbresëlënëse, pasi që roli i tyre në vendimmarrje është fare i vogël. Ky studim shënon edhe rëndësinë e veçantë të vetë profesionistit lidhur me rolin e tij/saj duke mundësuar diskutimin e opsioneve të mundshme përmes takimeve punuese në rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkolegjal në nivel institucionesh, menaxhimit e mirëfilltë, arritjen e rezultateve dhe përmirësimin e tyre. Nga gjetjet mund të konkludohet se preokupim i madh i profesionistëve ishin vështirësitë në zbatimin e procesit të mësimnxënies, bazuar në situatën aktuale.

Sipas studimit të realizuar në Qendrën Mjekësore Universitare në Heidelberg të Gjermanisë lidhur me rolet, përgjegjësitë dhe profilet e veprimtarisë së profesionistëve në kujdesin shëndetësor, edhe pse është i rregulluar me vendim sipas strukturave hirearkike organizative, sipas analizës gjenden dobësitë e sistemeve që përfshijnë përgjegjësitë e paqarta ose rolet kontradiktore, që janë të ngjashme me rezultatet e hulumtimit tim.

Sipas përgjigjeve të pjesëmarrësve, vërejmë se profesionistët shëndetësorë kanë interesim të madh, por që duhet ta kenë mundësinë e qasjes, diskutimit dhe sugjerimit. Kjo rezulton nga fakti se disa nga profesionistët që janë në pozita menaxheriale, nuk e shtyjnë këtë proces përpara, andaj shumica e profesionistëve shëndetësorë deklaruan se duhet të jetë në vazhdimësi rifreskimi i njohurive të tyre përmes aktiviteteve të ZHVP.

Sipas studimit të realizuar në Qendrën Mjekësore Universitare në Heidelberg të Gjermanisë, për të arritur cilësinë e lartë të kujdesit për pacientë, grupet e ndryshme profesionale dhe personeli administrative dhe menaxhues duhet të komunikojnë dhe bashkëpunojnë ngushtë. Çështja e aktorëve “është mjaft komplekse” andaj duhet të diskutohet dhe të rishikohet trajnimi i ekipeve, sepse vendimet që bëhen shpejtë, shpesh janë të pabazuara dhe me informata jo të plota. Këto rezultate janë të përafërta me të dhënat e fituara në hulumtimin tim. Mendimet e shprehura nga pjesëmarrësit në kuadër të grupeve punuese, janë si në vijim:

Vlerësimi i nevojave dhe ndërrimet e nevojshme për zhvillim – janë mëse të nevojshme rezultojnë nga përgjigjet e marra.

Pjesëmarrësit shprehën se duhet të rritet bashkëpunimi dhe përkrahja, pozita e profesionistit, sigurimi i kushteve të punës, rifreskimi i njohurive përmes ZHVP, ndërrimi i disa personave në fushën menaxheriale dhe rritja, forcimi dhe shkëmbimi i përvojave në mes tri niveleve të kujdesit shëndetësor.

Dizajnimi i konceptit që të zhvillohet më tutje përgjatë implementimit në rrethin punues – ishte njëra prej sfidave që e kishin profesionistët. Sipas pohimeve të tyre shihet se problemi qëndron në mjedisin ku punojnë, kushtet e punës, mos-stimulimin (pagat), mos bashkëpunimin ndërkolegjal, mos bashkëpunimin dhe përkrahjen menaxheriale, mos implementimin e njohurive të fituara gjatë trajnimeve dhe sistematizimin jo të drejtë në vendet e punës.

Metodat e mësuara dhe rezultatet e vlerësimit kritik a janë transferuar në praktikë – pjesëmarrësit deklaruan se problemi qëndron në radhë të parë tek vetë personeli shëndetësor, më pas tek stafi menaxherial i institucionit dhe komuniteti. Nga menaxherët dhe personat e trajnuar deri më tani nuk është marrë ndonjë iniciativë dhe nuk ekziston gatishmëria e vetë institucionit për një implementim dhe kontroll për efikasitetin në punë.

Aktivitetet që duhet kërkuar për ofrimin e shërbimeve shëndetësore më cilësore dhe më edukative për klientët, pacientët dhe familjarët – pjesëmarrësit në radhë të parë potencojnë se duhet të kenë një përkufizim të qartë të gjendjes

ku dëshirojnë të arrijnë dhe mënyrës së lëvizjes nga një gjendje në tjetrën. Të kenë informata të sakta, të bazohen në protokolet e punës (pasi që mungojnë) dhe të implementojnë aktivitetet e ndryshme përmes sesioneve këshilluese në parandalimin, edukimin dhe promovimin e shëndetit. Bashkëpunimi në mes tre niveleve dhe stafit menaxherial, mundësojnë sigurimin dhe kompletimin me materiale mësimore dhe mjete konkretizuese, me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore sa më cilësore dhe më edukative.

Formimi i ekipeve/grupeve të punës efektive për realizimin e ndryshimit – mirëpritet nga pjesëmarrësit, pasi grupet do të mund të organizonin një punë më të mirë, të identifikonin dhe plotësonin nevojat, të luanin rol në përmirësimin e kushteve të punës, planifikim të aktiviteteve të reja, vlerësimet profesionale, rritjen e bashkëpunimit dhe cilësisë, ndikim dhe këshilltar në menaxhment për komunikim të mirëfilltë, respektim të të tjerëve, rritje të përgjegjësive dhe kushteve më të mira në punë, përfshirë këtu edhe stimulimin.

Nëse i krahasojmë rezultat tona të cituara më lartë me studimin e realizuar në Qendrën Mjekësore Universitare në Heidelberg të Gjermanisë, vërejmë se rezultatet e fituara janë të përafërta dhe se nuk ka ndonjë dallim të madh sa i përket rolit dhe përgjegjësive të profesionistit shëndetësor, menaxhimit dhe strukturës së ekipit.

Në institucionet shëndetësore duhet të punohet akoma në zhvillimin e vazhdueshëm profesional lidhur me fuqizimin e rolit të profesionistit në vendimmarrje gjatë praktikimit të njohurive e në theks të veçantë gjatë zbatimit të Standardeve dhe Kompetencave gjithnjë duke u thirrur dhe bazuar në Kodin Etik.

Kërkesat e profesionistëve shëndetësore ishin që të gjithë punonjësit shëndetësor duhet ditur dhe fuqizuar rolin e tyre si profesionistë të denjë dhe të vërtetë. Nga deklaratimet e pjesëmarrësve duhet në vazhdimësi të bashkëpunohet dhe monitorohen për implementimin e njohurive (praktikimin) të profesionistëve shëndetësor duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë në sferën e tyre profesionale, gjithnjë duke synuar në arritjen e rezultateve.

Konkluzione

Në këtë studim nxjerrim në pah se zbatimi i ZHVP dhe forcimi i bashkëpunimit kolegjal ndihmon në identifikimin e problemeve të shumta që lidhen me fushën profesionale – kujdesin shëndetësor. Për këtë duhet siguruar që profesionistët shëndetësor duhet të ndryshojnë në vazhdimësi si përgjigje ndaj kërkesave të kohës me qëllim të përmirësimit të kualitetit në kujdesin profesional. Rezultatet e fituara në këtë studim shprehin brengat, nevojat dhe sugjerimet lidhur me ngritjen e tyre profesionale, bashkëpunimin kolegjal dhe menaxherial si dhe mjedisin punues.

Studimi pasqyron atë se në vendpunimet tona akoma shfrytëzohet fuqia personale më tepër se roli dhe pozita e profesionistit. Kërkesat e gjithë profesionistëve shëndetësore bazohen në nevojën e programeve trajnuese me qëllim të ngritjes profesionale, bashkëpunimit, harmonizimit dhe kujdesit në ngritjen e mirëqenies së pacientit.

Rezultatet e fituara të hulumtimit imponojnë kërkesën që profesionistët duhet të kenë një përkufizim të qartë të gjendjes ku dëshirojnë të arrijnë, të kenë informata të sakta, të hartojnë dhe bazohen në protokollet e punës me qëllim të implementimit të aktiviteteve të ndryshme në parandalimin, edukimin dhe promovimin e shëndetit.

Për arritjen e të gjitha performancave të duhura profesionale është e nevojshme që të funksionojnë individët dhe grupet punuese në organizimin, identifikimin, planifikimin, plotësimin dhe implementimin e aktiviteteve.

Bazuar në gjetjet e këtij hulumtimi, i propozohet stafit menaxherial në nivelin qendror dhe atij lokal shëndetësor në:

Institucionet shëndetësore profesionistët shëndetësor duhet të ndërmarrin masa me qëllim të evitimit të ngecjeve në procesin edukativ dhe implementues, konform ndryshimeve të reja në përparimin dhe ngritjen e njohurive dhe shkathësisë profesionale.

Forcimin e bashkëpunimit dhe zbatimin e ZHVP në kujdesin shëndetësor,

Implementimin e standardeve dhe ligjit shëndetësor,

Ngritjen e mekanizmave të posaçëm për minimizimin e rreziqeve dhe gabimeve profesionale,

Respektimin e statusit të profesionistit dhe rritjen e pagës,

Menaxhimin e burimeve njerëzore, mjedisit dhe kushteve të punës,

• Rishqyrtimin e rolit, pozitës dhe efikasitetit të menaxherit/punonjësit shëndetësor.

Involvimin dhe edukimin profesional të të gjithë profesionistëve shëndetësor,

Sigurimi i mjeteve didaktike dhe literaturës bashkëkohore shkencore.

Bibliografia

Association of Universities and Colleges of Canada. 2003. Profiling the impacts of North-South research collaboration for development.

Begolli I. 2001. Edukimi Shëndetësorë. Prishtinë

Carnegie D. 2003. Psikologjia e suksesit 3 – Si ta zhvillojmë mjeshtrinë e oratorisë dhe si ta fitoni vetëbesimin. Prishtinë

Doracak për standarde lidhur me etikën dhe të drejtat e njeriut për punëtorët shëndetësorë të fondacionit për trajnim mjekësor të Komwnuellthit, pjesa 3 - www.commat.org

- Epidemiologjia– Shëndeti Publik. 2003. Tiranë
- Ewles L, Simnett I. 2003. Promoting Health. A practical guide. Fifth edition. Bailliere Tindall
- Health Research Roadmap: Creating innovative research for better health and health care. CIHR's Strategic Plan 2009/10 – 2013/14.
- IKSHP të Kosovës: Resurset Humane në Shëndetësinë e Kosovës (Sektori Publik). 2011
- Institute for Health System Development (IHSD): Kosovo Education and Health Project; Health component. Final report. London 2003
- Jimmy Pelter and Andy Dahl – University of Wisconsin – Whitewater & Frank Mulhern – Northwestern University. April 2009. The relationship between employee satisfaction and hospital patient experiences.
- Kathleen Huttlinger, Jennifer M. Schaller-Ayers, Bernadette Kenny, James W. Ayers. 2004. Research and collaboration in rural community health .
- Kalo I. 2012. Katër faktorët për një revolucion të sistemit shëndetësor. Artikull. <http://www.mapo.al/2012/09/13/kater-faktoret-per-nje-revolucion-te-sistemit-shendetesor/>
- Key Findings. July 2003. Linking Employee Satisfaction with Productivity, Performance and Customer Satisfaction. CORPORATE LEADERSHIP COUNCIL
- Koliqi H. Andragogjia. 1990. Prishtinë
- Koxhaj A., Tomini F. 2006. Menaxhimi i Komunikimit. Tiranë
- KRCT (QKRMT) & ANTARES. Shqyrtimi i formës së pëlqim dhënies dhe dokumenteve tjera të hulumtimit. 2011. Prishtinë
- Kume V. 2007. Manaxhimi Strategjik. Teori, koncepte, zbatime. Tiranë Ligji për Shëndetësi i Kosovës. 2011
- Meunier Pierre J., Peraya D. 2009. Hyrje në teoritë e komunikimit. Tiranë
- MSH & AiK. 2004. Ngritja e cilësisë në praktikën profesionale. Prishtinë
- MSH / QZHMF. 2004. Programi i edukimit specialistik pasdiplomik në mjekësi familjare. Prishtinë
- MSH. Udhëzimi Administrativ (Shëndetësi) 22/2004 – Edukimi themelor profesional dhe provimi i licencës për punëtorët shëndetësor. 2004. Prishtinë
- MSH. Udhëzimi Administrativ (Shëndetësi) 01/2014 – Edukimi i Vazhdueshëm Mjekësor. 2014. Prishtinë
- Naidoo J., Wills J. 2000. Health Promotion. Foundations for practice. Second edition. Bailliere Tindall
- Psarolli Y., Kosta J., Hoxha A., Stratobërdha DH., Hasani V. 2003. Shëndeti Publik. Tiranë
- Ramadani N. 2003. Shëndetësia Publike & Etika. Prishtinë
- Ramosaj B. 2004. Management – Bazat e menaxhimit. Universiteti i Prishtinës
- Rezolutë për përfshirjen e etikës mjekësore dhe të drejtat e njeriut në programin mësimor të fakulteteve të mjekësisë në botë (Miratuar nga ana e Asamblesë së 51 të Shoqatës Botërore Mjekësore, Tel Aviv, Izrael, tetor 1999) doracak
- Strategjia e Zhvillimit të Sistemit Shëndetësor të Kosovës 2005-2015
- Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2010-2014. Ministria e Shëndetësisë në Kosovë. 2009
- Yorkshire Centre for Health Informatics. LEEDS INSTITUTE OF HEALTH SCIENCES. Overcoming barriers to the use of patient data for Research and Development between the National Health Service and Higher Education. A Briefing Paper for the UK Faculty of Health Informatics March 2009.
- World Medical Association Policy Handbook www.wma.net/e/policy/hanbook.html - përmban tërë tekstin e vijëveprimit të SHBM-së (në gjuhën angleze, franceze & spanjolle)

PËRFORCIMI DHE MENAXHIMI I RESURSEVE NJERËZORE NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE NË KOSOVË

EGLANTINA KRAJA

Doktorante në UET – Drejtimi Psikologji

NIMAN BARDHI

Doktorant në UET – Drejtimi Psikologji

ABSTRAKT

Lidhur me përforcimin dhe menaxhimin e resurseve njerëzore në institucionet shëndetësore, janë organizuar dhe zbatuar shumë programe edukative dhe arsimore për resurset shëndetësore lidhur me zhvillimin e lidershit.

Qëllimi: i hulumtimit ishte vlerësimi i opinioneve të profesionistëve shëndetësor lidhur me rolin e liderit në menaxhimin efektiv të resurseve njerëzore dhe praktikimin e shkathtësive të nevojshme në institucionin ku punon dhe vepron. Objektivi i përgjithshëm ishte njohja, analizimi dhe identifikimi i rolit të liderit në menaxhimin efektiv të resurseve njerëzore.

Hulumtimi është realizuar gjatë periudhës Maj – Nëntor 2014, në: Prishtinë, Mitrovicë, Gjiilan, Pejë, Prizren, Gjakovë dhe Ferizaj, ku janë intervistuar 293 punonjës në tri nivelet e kujdesit shëndetësor në Kosovë.

Rezultatet: Gjetjet pasqyrojnë se në institucionet shëndetësore në Kosovë problemet kryesore gjenerojnë nga mos zbatim i ligjeve. Bashkëpunimi mes punonjësve dhe lidershit nuk qëndron në nivel, ku 71% e punonjësve deklaruan se nuk informohen lidhur me aktivitetet. 50.9% e punonjësve deklarojnë se janë të pa kënaqur lidhur me mjedisin punues dhe organizimin menaxherial në institucionet e tyre.

Konkludim: stafi menaxhues deklarohet se nuk i është dhënë roli i duhur, përderisa sa punonjësit sugjerojnë se menaxhmenti duhet të bashkëpunojë dhe të jenë të përkushtuar për ndryshime, bazuar në detyrat/përgjegjësitë duke synuar arritjen e rezultateve. Shëndetësisë kosovare i nevojiten ndryshime të domosdoshme në menaxhimin e burimeve njerëzore në tri fusha: akademike-universitare, politikat publike dhe organizative. Realizimi i këtyre pikave do të ndikonte pozitivisht në përforcimin e burimeve njerëzore, rritjen e bashkëpunimit dhe lehtësimin në marrjen e vendimeve për ndryshime.

Fjalë kyç: *punonjësit, lidershipi, institucionet shëndetësore*

Hyrje

Shumë programe janë zhvilluar për ngritjen profesionale në shëndetësi lidhur me zhvillimin e lidershipit. Idetë dhe përvojat e paraqitura në këtë studim, bazohen në opinionet e paraqitura nga profesionistët shëndetësorë në cilësitë, aftësitë, kompetencat dhe shkathtësitë e njerëzve në situatat kur kërkohet lidership.

Zhvillimi i lidershipit, duke u bazuar në modelet që fokusohen në karakteristikat individuale, shpesh ndihmon zhvillimin personal dhe veprime të dobishme në institucion. Kërkimet e pavarura, diskutimet e çështjeve në këndvështrime të ndryshme, analizimi i tyre, identifikimi i problemeve, komunikimi dhe dialogu ishin qëllimi që të punohet bashkërisht në grupe dhe në njohjen e përafërt të rolit të lidershipit dhe menaxhmentit.

Kompetencat zakonisht definojnë si ato karakteristika të personit që ka gjasa të prodhojnë performancë efektive dhe/apo superiore në kuadër të një roli të caktuar. Këto karakteristika nuk kanë të bëjnë thjesht me shkathtësi dhe njohuri, por këtu po ashtu hyjnë edhe vlerat, qëndrimi dhe aspektet e personalitetit. Është me rëndësi të kuptohet se nuk është e thënë që nëse keni mangësi sa i përket një kompetence ju duhet patjetër ta zhvilloni atë. Gjithnjë do të ketë dallime në përgjegjësitë e liderëve dhe rrjedhimisht do të ketë dallime edhe në karakteristikat e nevojshme që duhet t'i ketë një lider.

Ky studim kishte për qëllim vlerësimin e opinionëve të profesionistëve shëndetësor lidhur me rolin e liderit në menaxhimin efektiv të resurseve njerëzore dhe praktikimin e shkathtësive të nevojshme në institucionin ku punon dhe vepron. Duke identifikuar në mënyrë efikase raportet kolegjiale dhe ndër-kolegjiale dhe raportet në mes lidershipit – menaxhmentit dhe punëtorit, gjetjet në këtë studim mund të ndihmojnë në përcaktimin e prioriteteve në institucionet shëndetësore lidhur me lidershipin dhe menaxhmentin.

Shqyrtimi i problemit

Janë bërë përparime të konsiderueshme lidhur me zhvillimin profesional në sektorin e shëndetësisë e veçanërisht në përforcimin e kapaciteteve dhe resurseve njerëzore, por edhe pse shumë programe trajnuese janë realizuar lidhur me lidershipin dhe menaxhmentin prapë aftësitë dhe shkathtësitë në implementim nuk qëndrojnë në nivel adekuat. Lidershipi është një çështje rreth të cilës është diskutuar dhe debatuar shumë, si për aspektin teorik ashtu edhe për atë praktik, dhe për individë të ndryshëm dhe në rrethana të ndryshme ajo merr kuptime të ndryshme. Nuk ekziston një definicion i vetëm korrekt për lidershipin, apo një grup i vetëm i cilësive dhe kompetencave personale që do të karakterizojnë një lider. Në vend të kësaj, shumica e qasjeve ndaj lidershipit, bazohen në modelet e kompetencës personale dhe fokusohen në individin.

Bazuar nga të dhënat në të gjitha nivelet e kujdeseve shëndetësore duhet që të gjithë profesionistët shëndetësorë të kenë ngritje profesionale në sferën menaxheriale, me qëllim të ju mundësohet të identifikojnë rolin e lidershipit në menaxhimin efektiv të resurseve njerëzore dhe të praktikojnë shkathtësitë e nevojshme për realizimin e ndonjë ndryshimi në institucionet ku punojnë dhe veprojnë. Duhet përmendur edhe aktivitetet e tjera si rregullimi i ambienteve dhe objekteve shëndetësore, zbatueshmërinë e metodave të reja menaxheriale, edukimin profesional dhe forcimin e bashkëpunimit ndër-kolegjial. Si faktorë të cilët mund të kontribuojnë në këtë situatë janë vetë liderët - menaxherët e institucioneve dhe të gjithë profesionistët shëndetësorë. Gjatë shqyrtimit të efektivitetit në lidership, është me rëndësi të vlerësohen karakteristikat që posedoni dhe të konsideroni sa janë relevante ato për rolin tuaj në kuadër të shërbimeve shëndetësore.

Përforcimi dhe menaxhimi i resurseve njerëzore në institucionet shëndetësore në Kosovë

Menaxhmenti si disiplinë shkencore përveç funksionit të planifikimit, organizimit, personelit (kuadrit) dhe kontrollit, në vete përmban edhe funksionin e udhëheqjes. Duke u mbështetur në kuptimin se udhëheqja është aftësia e personit për të ndikuar në të tjerët ashtu që ata të bashkëveprojnë në kërkesën për të realizuar qëllimet e përbashkëta, gjate realizimit të detyrave të tij, udhëheqësi/lideri, duhet të ballafaqohet me një sërë sfidash të ndryshme.

Që puna e liderit/menaxherit të jetë e suksesshme, duhet të ketë parasysh disa momente të rëndësishme, si:

Ti njohë mirë njerëzit dhe motivet e tyre,

Të krijojë një mjedis të tillë që të ndikojë pozitivisht në rritjen e motivimit dhe të përkushtimit të punonjësve në punë,

Të ndjekë me kujdes zhvillimin e situatës, me qëllim që t'i marrë vendimet në momentin më të përshtatshëm,

Të jetë shembull për të tjerët, një lider i suksesshëm, para së gjithash, udhëheq me shembullin e tij personal.

Udhëheqja është një funksion menaxhues të cilit po i rritet rëndësia vazhdimisht dhe duke ndikuar në motivimin e punonjësit në arritjen e synimeve të institucionit.

Udhëheqje, do të thotë krijimi i kulturës se vlerave të përbashkëta dhe komunikimi i synimeve tek të gjithë punonjësit në organizatë.

Udhëheqje do të thotë motivimi i departamenteve dhe njësive po ashtu edhe i vartësve të drejtpërdrejtë.

Punonjësit kanë nevojë për t'u aktivizuar në veprim dhe kjo kërkon veprimin e udhëheqësve të cilët kanë vizion dhe janë të aftë që ta komunikojnë atë vizion.

Modeli i lidërshiptit që diskutohet në këtë studim, ka tri aspekte kryesore:

Karakteristikat – personale si: cilësitë, aftësitë, kompetencat dhe shkathtësitë.

Kontesti - karakteristikat e përgjithshme të lidërshiptit nuk varen nga konteksti, por karakteristikat e lidërshiptit gjithnjë janë kontekstuale.

Sfidat - lidërshipti, në radhë të parë ka të bëjë me njohjen, mobilizimin dhe marrjen e vendimeve kur ekzistojnë probleme apo çështje kritike.

Është vështirë të bëhet një përkufizim i qartë ndërmjet kuptimit “menaxhment” (menagement) dhe “udhëheqje” (leadership). Tek ne, fjala menaxher përdoret si sinonim i qeverisjes, drejtorit, drejtuesit, ndërmarrësit (biznesmenit), udhëheqësit në përgjithësi. Konsiderohet se menaxhimi përfshin tërë procesin menaxhues, nga planifikimi, punësimi, drejtimi, bashkërenditjen, ekzekutimin (vendosjen) dhe kontrollin. Fred Luthans & Richard M. Hoxhëts konstatojnë se krahas motivimit, përmasë tjetër kryesore e funksionit drejtues të menaxhimit është udhëheqja, dhe se ajo ka të bëjë me procesin e të ndikuarit tek njerëzit për të drejtuar përpjekjet e tyre drejt arritjes së objektivave të veçanta. Për të kuptuar procesin e udhëheqjes, padyshim duhet njohur idetë mbi *autoritetin, sjelljet dhe motivet*, që ndikojnë në njeriun dhe në tërësinë komplekse të tij. Një udhëheqës, thuhet se i motivon vartësit e tij atëherë kur ai kryen ato gjëra të cilat beson se do t'i kënaqin nevojat, dëshirat dhe kërkesat e tyre dhe i nxisin ata që të veprojnë në një mënyrë të dëshirueshme prej tij. Udhëheqësit kanë qenë në dijeni për rëndësinë e motivimit të punonjësve shumë kohë më parë, por mendimi i tyre për këtë çështje ka evoluar duke kaluar nëpër tri faza:

Pikëpamja tradicionale - është përhapur në kohën e F. Taylor-it, i cili i përmbahej parimit, se njerëzit në punë motivohen vetëm nga arsyeja ekonomike. Kjo pikëpamje mbështetet në supozimet e studiuesit D. Mc Gregory në teorinë e tij “X” mbi natyrën e njerëzve.

Pikëpamja e marrëdhënieve njerëzore – forcat sociale janë përcaktuesit kryesorë për motivimin e njerëzve (moralin e punëtorëve, komunikimin e përshtatshëm dhe kënaqësinë në punë).

Pikëpamja e burimeve njerëzore - njerëzit janë burimi kryesor dhe më i çmueshëm i organizatës, prandaj duhen trajtuar si një pasuri me mjaft vlerë. Kjo pikëpamje mbështetet në teorinë “Y”

Lehtësimi i punës për të tjerët lidhet me disa aktivitete të tjera të cilat i kryen menaxheri, përveç aktiviteteve tradicionale të menaxhimit siç janë planifikimi, vendimmarrja dhe kontrolli. Këtu mund të përmendim lehtësimin e punës për të tjerët përmes aktiviteteve si:

Shpërndarja e informatave / komunikimi,
Socializimi – ndërveprimi me të tjerët,
Resurset njerëzore – trajnimi dhe zhvillimi.

Siç e përshkruan Douglas, përveç aftësive si ekspertiza teknike dhe përgatitja, menaxheri duhet të zhvillojë edhe aftësitë sociale si këshillimi dhe përkrahja për personelin. Menaxherët më të suksesshëm janë ata që janë fleksibile dhe mund të përshtatin shfrytëzimin e aftësive të tyre sipas kërkesave të punës, si nga ana e aftësive teknike dhe vendimmarrëse, ashtu edhe nga ana e aftësive sociale të krijimit të ambientit të përshtatshëm për punë në organizatë. Përderisa një ndër mënyrat e definimit të menaxhimit është “kryerja e punëve përmes njerëzve tjerë”. Që të arrihet kjo, menaxheri kryen aktivitetet e delegimit të detyrave si dhe fuqizimit të punëtorëve për t'i kryer ato detyra. Kjo përfshin jo vetëm ndarjen e punëve por edhe ndihmën dhe lehtësimin e punës për ekipin.

Qëllimi

Ky studim kishte për qëllim vlerësimin e opinioneve të profesionistëve shëndetësorë lidhur me rolin e liderit në menaxhimin efektiv të resurseve njerëzore dhe praktikimin e shkathtësive të nevojshme në institucionin ku punon dhe vepron. Duke identifikuar në mënyrë efikase raportet kolegjiale dhe ndër-kolegjiale dhe raportet në mes lidërshiptit – menaxhmentit dhe punëtorit, gjetjet në këtë studim mund të ndihmojnë në përcaktimin e prioriteteve në institucionet shëndetësore lidhur me lidërshiptin dhe menaxhmentin.

Objektivat

Objektivi i përgjithshëm i këtij studimi është njohja, analizimi dhe identifikimi i rolit të liderit në menaxhimin efektiv të resurseve njerëzore në institucionet shëndetësore në Kosovë, si dhe:

Përshkrimi i procesit të ndryshimit dhe faktorët që ndikojnë në mënyrën se si reagojnë njerëzit ndaj ndryshimeve,
Maksimalizimin e efektivitetit të tyre si liderë,
Aplikimi i disa teknikave dhe shkathtësive komunikuese për të ndikuar tek të tjerët dhe për të përfshirë ata në realizimin e ndryshimit.

Pyetjet hulumtuese

Cilat janë opinionet e profesionistëve shëndetësor lidhur me stilet e lidhshimit dhe menaxhmentit në sektorin e shëndetësisë?

Cilët faktorë ndikojnë në mënyrën se si reagojnë njerëzit ndaj ndryshimeve?

Metodologjia

Studimi rezultoi me mbledhjen e të dhënave në mënyrë numerike, duke bërë analizimin dhe ekzaminimin real të rrethanave në të cilën ndodhen profesionistët shëndetësorë duke dhënë opinionet e tyre lidhur me lidhshimin në institucionet ku ata punojnë. Statistikat deskriptive (përqindjet, mesataret, etj.) janë përdorur për përshkrimin e situatës aktuale, duke përshkruar konceptet dhe identifikimet si bazë për këtë hulumtim kuantitativ. Të dhënat janë mbledhur me ndihmën e listës evidentuese dhe pyetësorëve anonim të strukturuar me pyetje të hapura dhe të mbyllura për zhvillimin e evolucionit të profesionistëve shëndetësorë.

Studimi është bazuar në grumbullimin e të dhënave numerike nga gjithsejtë 293 profesionistëve shëndetësor, përdorur pyetësorët e evolucionit të kanës plotësuar 263 (89.8%) prej tyre. Studimi është realizuar gjatë periudhës Maj – Nëntor 2014.

Mostra është e shumëfishtë, përfshihen: profesor, menaxherë (drejtor, kryeshf, shef, kryeinfermier) dhe profesionistë të tjerë shëndetësor nga institucione të ndryshme shëndetësore. Përfaqësimi ishte nga shtatë qendrat regjionale përfshirë edhe komunat që kanë vartësi nga regjioni: Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Pejë, Prizren, Gjakovë dhe Ferizaj (shih tab.nr.1).

TABELA NR. 1: PJESËMARRËSIT REGJIONAL DHE VENDI I TAKIMIT PUNUES DHE EVOLUES

Nr.	Regjionet pjesëmarrëse	Vendet e takimeve punuese
1.	Prishtinë, Besianë, F. Kosovë, Lipjan, Shtime, Kastriot, Drenas.	Prishtinë – QKUK
2.	Mitrovicë, Vushtri.	Mitrovicë – QKMF
3.	Gjilan, Dardanë.	Gjilan – Spitali Regjional
4.	Pejë, Burim, Klinë, Deçan, Dubravë.	Pejë – Spitali Regjional
5.	Prizren, Therandë.	Prizren – Spitali Regjional
6.	Gjakovë, Malishevë, Rahovec.	Gjakovë – QKMF
5.	Ferizaj	Ferizaj – QKMF

Rezultatet

Bazohen në tri instrumentet matës, si: lista e evidentimit (instrumenti 1); pyetësori para mbajtjes së takimit/evoluimit lidhur me informimin e drejtë të të ftuarve (instrumenti 2) dhe evoluimin në formë të shkruar (instrumenti 3).

Instrumenti 1

Në listën e evidentimit janë kërkuar të dhënat për moshën, gjininë, regjionin, titullin, vendpunimin. Në këtë studim kanë marrë pjesë dhe janë evidentuar gjithsejtë 293 pjesëmarrës, që përfaqësonin kujdesin parësor, dytësor dhe tretësor shëndetësor. Duhet theksuar se në shtatë regjionet ku janë mbajtur takimet punuese dhe evoluese, pjesëmarrësit ishin edhe të regjioneve të tjera, arsyeja ishte që të mbulohen të gjitha nivelet regjionale me qëllim të identifikimit, analizimit dhe përshkrimit të gjendjes aktuale në sistemin shëndetësor. (shih tab.nr.1)

Numri i pjesëmarrësve sipas regjioneve që kanë marrë pjesë në këtë studim, ishte: Prishtinë = 41 (14%), Mitrovicë = 34 (11.6%), Gjilan = 37 (12.6%), Pejë = 45 (15.3%), Prizren = 41 (14%), Gjakovë = 57 (19.5%) dhe Ferizaj = 38 (13%) pjesëmarrës, (Shih tabelën nr.2). Përfaqësimi i përgjithshëm sipas niveleve të kujdesit shëndetësor nga shtatë regjionet, ishte:

Kujdesi Parësor Shëndetësor = 136 (46.4%) pjesëmarrës

Kujdesi Dytësor Shëndetësor = 128 (43.7%) pjesëmarrës

Kujdesi Tretësor Shëndetësor = 29 (9.9%) pjesëmarrës

TABELA NR. 2: NUMRI I PËRGJITHSHËM I PËRFAQËSUESVE SIPAS NIVELEVE SHËNDETËSORE

Regjioni	KPSH		KDSH		KTSH		Gjithsejtë:	
	F	%	f	%	f	%	f	%
Prishtinë	19	6.5	2	0.7	20	6.8	41	14

Mitrovicë	15	5.1	17	5.8	2	0.7	34	11.6
Gjilan	17	5.8	19	6.5	1	0.3	37	12.6
Pejë	21	7.2	23	7.8	1	0.3	45	15.3
Prizren	16	5.4	24	8.3	1	0.3	41	14
Gjakovë	27	9.2	28	9.5	2	0.7	57	19.5
Ferizaj	21	7.2	15	5.1	2	0.7	38	13
Gjithsej:	136	46.4	128	43.7	29	9.9	293	100

Kemi dallim sinjifikant sipas regjioneve dhe gjinisë ($X_2 = 94.45$, $p < 0.01$)

Pjesëmarrës në këtë studim ishin 234 (79.9%) femra dhe 59 (20.1%) meshkuj. Grup-moshat e tyre ishin prej: 17–26 vjeç 61 (20.7%) pjesëmarrës, 62 (21.2%) pjesëmarrës ishin të moshës prej 27–36 vjeç, prej 37–46 vjeç ishin 119 (40.6%) pjesëmarrës, 47 (16.1%) pjesëmarrës ishin prej moshës 47–56 vjeç dhe vetëm 4 (1.4%) pjesëmarrës ishin të grup moshës 57–66 vjeç.

Pjesëmarrësit në studim ishin profesionistë të fushave dhe me thirrje/gradime të ndryshme, të profileve dhe vendpunimeve të ndryshme institucionale, si nga: Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Spitalet Regjionale, Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare, Qendra e Shëndetit Mendor në Bashkësi, Instituti i Mjekësisë së Punës, Enti Special në Shtime, Shtëpia e Pleqëve në Prishtinë dhe Qendra e Mirëqenies së Gruas në Gjilan.

Instrumenti 2

Pyetëtori për t'u plotësuar para mbajtjes së takimit kishte qëllim sa ishin të informuar pjesëmarrësit lidhur me takimin punues/ evolues, ku nga kjo shohim që 208 (71%) pjesëmarrës nuk ishin informuar, ndërsa 85 (29%) pjesëmarrës ishin informuar. Për pyetjet e adresuara nga instrumenti 2, kemi opinionet e udhëheqësve dhe profesionistëve shëndetësorë, si:

Çfarë njohurish shpresoni të përfitonit nga ky takim punues/evolues?

248 (84.6%) pjesëmarrës janë deklaruar se do të ju ndihmojë të kryejnë punën me efektivitet, ndërsa 45 (15.4%) pjesëmarrës janë deklaruar se do të kontribuojë në zhvillimin profesional.

A keni ndjekur ndonjë kurs trajnimi mbi menaxhimin e resurseve njerëzore?

262 (89.4%) pjesëmarrës nuk kanë ndjekur asnjë trajnim lidhur me menaxhimin, 30 (10.3%) pjesëmarrës janë deklaruar se kanë ndjekur trajnime por jo për menaxhim, ndërsa vetëm 1 (0.3%) pjesëmarrës ka ndjekur kursin e trajnimit për menaxhimin e resurseve njerëzore.

Shkathtësitë dhe cilësitë personale që do të sjellin në takimin punues/evolues?

292 (99.7%) pjesëmarrës janë deklaruar se është hera e parë që marrin pjesë në trajnim për menaxhim dhe nuk dinë se çfarë shkathtësi apo cilësi do të ofrojnë gjatë këtij takimi punues/evolues, pasi që nuk kanë përvojë personale dhe profesionale në menaxhim, përderisa vetëm 1 (0.3%) pjesëmarrës është deklaruar se do të ofroj gatishmëri dhe ide në sferën e lidhshëm dhe menaxhimit.

Keni ndonjë rezervë/shqetësim lidhur me takimin punues/evolues?

261 (89.1%) pjesëmarrës janë deklaruar se ndihen shumë mirë dhe nuk kanë ndonjë shqetësim, ndërsa 32 (10.9%) pjesëmarrës janë deklaruar se ndihen të shqetësuar pasi që për ta është hera e parë që marrin pjesë në takimin punues/ evolues lidhur me menaxhimin e resurseve njerëzore.

A është prezentë në këtë takim ndonjë koleg i institucionit me të cilin punoni?

285 (97.3%) pjesëmarrës janë deklaruar se kanë edhe kolegë të tjerë të institucionit në të cilin punojnë, ndërsa 8 (2.7%) pjesëmarrës janë deklaruar se nuk kanë kolegë të tjerë të institucionit në të cilin punojnë në këtë takim punues/evolues.

Instrumenti 3

Pyetëtori i evoluimit kishte për qëllim satisfaksionin e profesionistëve lidhur me aktivitetin punues/evolues, mësimnxënien dhe menaxhimin ku është plotësuar nga 263 pjesëmarrës. Satisfaksioni i profesionistëve lidhur me përmbushjen e synimeve të takimit punues/evolues dhe mësimnxënies!

TABELA NR. 3: SATISFAKSIONI I PROFESIONISTËVE

Satisfaksioni	Regjioni															
	Prishtinë		Mitrovicë		Gjilan		Pejë		Prizren		Gjakovë		Ferizaj		Gjithsej:	
	f	%	f	%	f	%	f	%	F	%	f	%	f	%	F	%
Shumë mirë	24	9.1	20	7.5	14	5.3	19	7.2	18	6.8	33	12.5	22	8.3	150	57.0
Mirë	10	3.8	7	2.7	15	5.7	16	6.1	12	4.6	10	3.8	7	2.7	77	29.3
Në nivel adekuat	2	0.8	2	0.8	4	1.5	6	2.3	8	3.0	7	2.7	5	1.9	34	12.9

Jo kënaqshëm	-	-	1	0.4	-	-	-	-	1	0.4	-	-	-	-	2	0.8
Dobët	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shumë Dobët	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej: f (F+M)	36		30		33		41		39		50		34		263	
Gjithsej: % (F+M)	13.7		11.4		12.5		15.6		14.8		19.0		12.9		100	

Nga analizimi i vlerave të observuara të anketuarve kemi dallim sinjifikant ($X_2 = 2.79, p < 0.05$)

Satisfaksioni i profesionistëve në përbushjen e synimeve të takimit punues/evolues dhe mësimnxënie, për: 150 (57%) pjesëmarrës ishte shumë mirë, 77 (29.3%) pjesëmarrës ishte mirë, 34 (12.9%) pjesëmarrës ishte në nivel adekuat, ndërsa për 2 (0.8%) pjesëmarrës ishte jo kënaqshëm. (Shiko tabelën nr. 3).

Satisfaksioni i profesionistëve me lidërsipin, mjedisin dhe kushtet e punës!

TABELA NR. 4: SATISFAKSIONI I PROFESIONISTËVE ME LIDËRSHIPIN, MJEDISIN DHE KUSHTET E PUNËS

A jeni të kënaqur me:	Aspak i kënaqur		Pak i kënaqur		I kënaqur		Shumë i kënaqur		TOTALI	
	f	%	f	%	f	%	f	%	F	%
Me mjedisin e jashtëm të institucionit ku ju punoni?	68	25.9	73	27.7	94	35.8	28	10.6	263	100
Me mjedisin e brendshëm të institucionit ku ju punoni?	64	24.3	79	30.0	85	32.3	35	13.4	263	100
Me marrjen e informatës në kohë nga menaxhmenti juaj?	67	25.4	68	25.9	93	35.3	35	13.4	263	100
Me marrëdhëniet tuaja dhe atij menaxherial?	48	18.3	78	29.7	109	41.4	28	10.6	263	100
Me takimet e organizuara nga stafi menaxherial?	53	20.2	81	30.8	100	38	29	11	263	100
Produktivitetin e takimeve të ekipit	56	21.3	68	25.9	103	39.1	36	13.7	263	100
Pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje?	100	38	91	34.6	53	20.2	19	7.2	263	100
Aftësinë e menaxherit për të lehtësuar punën për të tjerët?	57	21.7	81	30.8	112	42.6	13	4.9	263	100
Aftësinë e menaxherit për delegim?	59	22.5	68	25.7	120	45.7	16	6.1	263	100
Aftësinë e menaxherit për organizim dhe kontroll?	47	17.9	79	30	108	41.1	29	11	263	100
Aftësinë e menaxherit në planifikim?	67	25.5	74	28.1	84	31.9	38	14.5	263	100
Aftësinë e menaxherit për komunikim me të tjerët?	37	14.1	71	27	102	38.8	53	20.1	263	100
Aftësinë e menaxherit për motivimin e të tjerëve?	38	14.5	72	27.4	99	37.6	54	20.5	263	100
Aftësinë e menaxherit për të zhvilluar individin?	55	20.9	69	26.2	104	39.4	35	13.3	263	100
Nga analizimi i vlerave të observuara është fituar dallim sinjifikant ($X_2 = 44.13, p < 0.01$)										

A jeni të kënaqur me mjedisin e jashtëm të institucionit ku ju punoni?

68 (25.9%) pjesëmarrës nuk janë aspak të kënaqur, 73 (27.7 %) pjesëmarrës janë pak të kënaqur, 94 (35.8 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 28 (10.6%) pjesëmarrës janë shumë të kënaqur me mjedisin e jashtëm të institucionit ku punojnë.

A jeni të kënaqur me mjedisin e brendshëm të institucionit ku ju punoni?

64 (24.3%) pjesëmarrës nuk janë aspak të kënaqur, 79 (30 %) pjesëmarrës janë pak të kënaqur, 85 (32.3 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 35 (13.4%) pjesëmarrës janë shumë të kënaqur me mjedisin e brendshëm të institucionit ku punojnë.

A jeni të kënaqur me marrjen e informatës në kohë nga menaxhmenti juaj?

67 (25.4%) pjesëmarrës nuk janë aspak të kënaqur, 68 (25.9 %) pjesëmarrës janë pak të kënaqur, 93 (35.3 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 35 (13.4%) pjesëmarrës janë shumë të kënaqur me marrjen e informatës në kohë nga menaxhmenti i tyre.

A jeni të kënaqur me marrëdhëniet tuaja dhe atij menaxherial?

48 (18.3%) pjesëmarrës janë deklaruar se nuk janë aspak të kënaqur, 78 (29.7 %) pjesëmarrës janë pak të kënaqur, 109 (41.4 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 28 (10.6%) pjesëmarrës janë shumë të kënaqur me marrëdhëniet e tyre me menaxhmentin.

A jeni të kënaqur me takimet e organizuara nga stafi menaxherial?

53 (20.2%) pjesëmarrës janë deklaruar se nuk janë aspak të kënaqur, 81 (30.8 %) pjesëmarrës janë pak të kënaqur, 100 (38 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 29 (11%) pjesëmarrës janë shumë të kënaqur me takimet e organizuara nga stafi menaxherial.

A jeni të kënaqur me produktivitetin e takimeve të ekipit?

56 (21.3%) pjesëmarrës janë deklaruar se nuk janë aspak të kënaqur, 68 (25.9 %) pjesëmarrës janë pak të kënaqur,

103 (39.1 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 36 (13.7%) pjesëmarrës deklarohen se janë shumë të kënaqur me produktivitetin e takimeve të ekipit.

A jeni të kënaqur me pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje?

100 (38%) pjesëmarrës janë deklaruar se nuk janë aspak të kënaqur, 91 (34.6 %) pjesëmarrës janë pak të kënaqur, 53 (20.2 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 19 (7.2 %) pjesëmarrës deklarohen se janë shumë të kënaqur me pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje.

A jeni të kënaqur me aftësinë e menaxherit për të lehtësuar punën për të tjerët?

57 (21.7 %) pjesëmarrës janë deklaruar se nuk janë aspak të kënaqur, 81 (30.8 %) pjesëmarrës janë pak të kënaqur, 112 (42.6 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 13 (4.9 %) pjesëmarrës janë shumë të kënaqur me aftësinë e menaxherit për të lehtësuar punën për të tjerët.

A jeni të kënaqur me aftësinë e menaxherit për delegim?

59 (22.5 %) pjesëmarrës janë deklaruar se nuk janë aspak të kënaqur, 68 (25.7 %) pjesëmarrës janë pak të kënaqur, 120 (45.7 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 16 (6.1 %) pjesëmarrës janë shumë të kënaqur me aftësinë e menaxherit për delegim.

A jeni të kënaqur me aftësinë e menaxherit për organizim e kontroll?

47 (17.9 %) pjesëmarrës janë deklaruar se nuk janë aspak të kënaqur, 79 (30 %) pjesëmarrës janë pak të kënaqur, 108 (41.1 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 29 (11 %) pjesëmarrës janë shumë të kënaqur me aftësinë e menaxherit për organizim e kontroll.

A jeni të kënaqur me aftësinë e menaxherit në planifikim?

67 (25.5 %) pjesëmarrës janë deklaruar se nuk janë aspak të kënaqur, 74 (28.1 %) pjesëmarrës janë pak të kënaqur, 84 (31.9 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 38 (14.5 %) pjesëmarrës janë shumë të kënaqur me aftësinë e menaxherit për planifikim.

A jeni të kënaqur me aftësinë e menaxherit për komunikim me të tjerët?

37 (14.1 %) pjesëmarrës janë deklaruar se nuk janë aspak të kënaqur, 71 (27 %) pjesëmarrës janë pak të kënaqur, 102 (38.8 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 53 (20.1 %) pjesëmarrës janë shumë të kënaqur me aftësinë e menaxherit për komunikim me të tjerët.

A jeni të kënaqur me aftësinë e menaxherit për motivimin e të tjerëve?

38 (14.5 %) pjesëmarrës janë deklaruar se nuk janë aspak të kënaqur, 72 (27.4 %) pjesëmarrës janë pak të kënaqur, 99 (37.6 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 54 (20.5 %) pjesëmarrës janë shumë të kënaqur me aftësinë e menaxherit për motivimin e të tjerëve.

A jeni të kënaqur me aftësinë e menaxherit në zhvillimin e individit?

55 (20.9 %) pjesëmarrës janë deklaruar se nuk janë aspak të kënaqur, 69 (26.2 %) pjesëmarrës se janë pak të kënaqur, 104 (39.4 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 35 (13.3 %) pjesëmarrës janë shumë të kënaqur me aftësinë e menaxherit për të zhvilluar individin.

Diskutime

Qëllimi i këtij studimi ishte vlerësimi i opinionëve të profesionistëve shëndetësor lidhur me rolin e liderit në menaxhimin efektiv të resurseve njerëzore dhe praktikimin e shkathhtësive të nevojshme në institucionin ku punon dhe vepron.

Studimi është bazuar në grumbullimin e të dhënave numerike nga gjithsejtë 293 profesionistëve shëndetësor, përderisa pyetësorët evolues i kanë plotësuar 263 (89.8%) prej tyre. Studimi është realizuar gjatë periudhës Maj – Nëntor 2014. Të dhënat janë mbledhur me ndihmën e listës evidentuese dhe pyetësorëve anonim të strukturuar me pyetje të hapura dhe të mbyllura për zhvillimin evolues të profesionistëve shëndetësorë.

Bazuar në gjetjet e studimit të realizuar në shtatë regjionet vërejmë se gjinisë mashkullore i takojnë 20.1%, ndërsa gjinisë femërore 79.9%. Grup moshë ishte e ndarë në 5 grupe: 17 – 26 vjeç, 27 – 36 vjeç, 37 – 46 vjeç, 47 – 56 vjeç dhe 57 – 66 vjeç. Moshë mesatare në këtë studim ishte mbi 30 vjeç.

Sipas studimit të realizuar në Universitetin e Romës “Vergata Tor” në Fakultetin e Mjekësisë dhe Kirurgjisë, anketat janë administruar gjatë periudhës Janar – Mars 2010, ku janë anketuar 670 profesionistë që kanë punuar në njësi mjekësore dhe sallat e operacionit në gjashtë spitalet universitare italiane. Anketën nga numri i përgjithshëm e kishin plotësuar siç duhet 542 (80.9%) pjesëmarrës. Grup-moshat i takonin: gjinisë mashkullore 35%, ndërsa gjinisë femërore 65%. Profesionistët i kishin ndarë në dy grupe: të rinjtë prej moshës 24 – 42 vjeç dhe më të vjetër nga 43 – 59 vjeç. Moshë mesatare sipas këtij studimi ishte mbi 35 vjeç.

Të dhënat e paraqitura në hulumtimin tim, janë të përafërta me hulumtimin e realizuar në Universitetin e Romës për sa i përket numrit të institucioneve të përzgjedhura, ndërsa për sa i përket numrit të të anketuarve, ekziston dallim.

Konceptet moderne të menaxhimit të burimeve njerëzore nënkuptojnë menaxhimin e kompetencave, kënaqësinë e klientit nga shërbimi dhe përgjegjshmërinë e punonjësve. Drejtuesit e burimeve njerëzore janë gjithmonë e me tepër të ndërgjegjshëm se pa *joshjen, zhvillimin dhe qëndrimin në punë* të më të mirëve, institucioni nuk mund të sigurojë satisfaksionin e klientit, pra të sigurojë një zhvillim të vazhdueshëm të saj. Në vendet e zhvilluara perëndimore, menaxhimi i burimeve njerëzore është kthyer në një specialitet kompleks të qëndrueshëm, me procedura specifike të integruara sipas modeleve më të fundit të

tregut. Vende të ndryshme aplikojnë dhe modele të ndryshme të menaxhimit të burimeve njerëzore, si ai anglez “Investitorët në Njerëz” (Investors in People) apo atë amerikan “Modeli Aftësi Pjekurie – në popull” Capability Maturity Model – People (CMM-P).

Të tjerët kanë krijuar ligje që reflektojnë zhvillimin e këtyre koncepteve. Në Francë mund të përmendim disa ligje që kanë të bëjnë me burimet njerëzore si: ligji mbi formimin profesional, ligji mbi tërësinë e kompetencave dhe ligji mbi të drejtën individuale të formimit. Në Shqipëri funksioni i burimeve njerëzore shpeshherë ka qenë i kufizuar në disa aktivitete specifike si: pagat e punonjësve, pushimet, mungesat e tyre, etj. Këto aktivitete njihen me funksionin e zyrës së “personelit”.

Sa i përket Kosovës, vëmë re se problemet kryesore gjenerojnë nga korniza ligjore. Rregullorja për Shërbimin Civil është hartuar në kohën kur Kosova është administruar nga UNMIK-u dhe kanë reflektuar çështjet e identifikuar në atë kohë. Në mënyrë që të tejkalohen një sërë problemesh të identifikuar në proceset e veçanta, duhen përfortuar njësitë qendrore, duke: përcaktuar standardet në ligje, miratuar sistemin e ri për klasifikimin e pozitave të punës (me standarde dhe udhëzime) që do të udhëhiqte ndërhyrjen në sistemin e pagave. Këto ndërhyrje janë thelbësore për të ardhmen në Kosovë.

Sipas analizës në pyetësorin vlerësues rezultoi fakti se disa nga profesionistët që janë në pozita menaxheriale, duhet të ndikojnë dhe veprojnë më shumë në shtyrjen e proceseve përpara, andaj, shumica e profesionistëve shëndetësorë deklaruan se duhet të kenë një bashkëpunim dhe komunikim me qëllim të implementimit të ndryshimeve në institucionet ku punojnë.

Mendimet e shprehura nga pjesëmarrësit në kuadër të grupeve punuese, janë si në vijim:

Realizimi i ndryshimit dhe analizimi i fushës së forcave – shohim se ata kanë arritur të identifikojnë forcat pozitive (shtytëse) si dhe ato frenuese (penguese). Që të arrihet një ndryshim pozitiv duhet të ketë bashkëpunim dhe përkrahje nga profesionistët shëndetësor, lidhshipi dhe menaxhmenti. Pozita e profesionistëve shëndetësorë dhe kushtet e punës janë sfida më e madhe që ndikojnë në mos realizimin e ndryshimit, andaj duhet bërë një analizë e drejtë lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë që duhet të ketë secili punonjës.

Realizimi i ndryshimit bazuar në hartën e mjedisit/rrethit tuaj– ishte njëra prej sfidave që kishin profesionistët, pasi që sipas pohimeve të tyre shohim se problemi qëndron në mjedisin ku punojnë, kushtet e punës, mos stimulimi, mos bashkëpunimi ndërkolegjial, mos bashkëpunimi/përkrahja menaxheriale dhe sistematizimi jo i drejtë në vendet e punës.

Realizimi i ndryshimit dhe planifikimi i përkushtimit–krijimi i një mase të përkrahësve – problemi qëndron në pamundësinë që punëtorët të komunikojnë dhe dialogojnë me lidhshipin. Sipas pohimeve, deri më tani nuk është marrë ndonjë iniciativë për planifikim dhe implementim, njëherë nuk ekziston gatishmëria dhe përkushtimi tek disa liderë dhe menaxherë për të qenë përkrahës në implementim dhe kontrollim të efikasitetit në punë.

Formimi i ekipeve/grupeve të punës efektive për realizimin e ndryshimit – mund të organizonin një punë më të mirë, të identifikonin dhe plotësonin nevojat, të luanin rol në përmirësimin e kushteve të punës, planifikim të aktiviteteve të reja, vlerësimet profesionale, rritjen e bashkëpunimit dhe cilësisë, ndikim dhe këshilltar në menaxhment për komunikim të mirëfilltë, respektim të të tjerëve, rritje të përgjegjësisë dhe kushteve më të mira në punë, përfshirë këtu edhe stimulimin ish-in komentet e pjesëmarrësve. Përmes grupeve punuese dhe formimit të ekipeve mund të kenë informata të sakta, me qëllim të dizajnit-hartimit të aktiviteteve dhe të implementimit të tyre. Formimi i grupeve apo ekipeve do të ndikojë edhe në bashkëpunimin, komunikimin dhe dialogun në mes punonjësve dhe menaxhmentit.

Sipas studimit të realizuar në Universitetin e Romës “Vergata Tor” mbi analizimin e komoditetit në ambientin punues, kontekstin organizativ dhe kënaqësinë e punës, sipas Avallone dhe Paplomatas, rezultoi në krahasimin e 6 faktorëve më prioritarë:

Perceptimi i koordinatorëve (mospërputhje 11.2%),
Efikasiteti organizativ (mospërputhje 8.7%),
Zhvillimi i personelit (mospërputhje 7.2%),
Marrëdhëniet me kolegë (mospërputhje 6.4%)
Konfliktet (mospërputhje 4.2%)
Efektiviteti i organizatës (mospërputhje 4.3%)

Bazuar në këtë studim si pasojë e faktorëve të cituar më lartë, rezultoi fakti se e tërë kjo ndodh si pasojë e:

Punës së madhe (mospërputhje 19%),
Izolimit dhe punës rutinë (mospërputhje 9.8%),
Integritet të ekipit punues (mospërputhje 7.6%), dhe
Stresit (mospërputhje 5.1%).

Në shtatë regionet e hulumtuara lidhur me kënaqësinë e mjedisit institucional ku personeli shëndetësor punon, 66 (25.1%) pjesëmarrës janë deklaruar se nuk janë aspak të kënaqur, 76 (28.9%) pjesëmarrës janë pak të kënaqur, 89 (33.8 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 32 (12.2%) pjesëmarrës janë shumë të kënaqur.

Sipas studimit nga Universiteti i Romës “Vergata Tor”, perceptimi i efikasitetit institucional ka një efekt pozitiv dhe të rëndësishëm për personelin më të ri, ndërsa sa i përket marrëdhënieve në punë me kolegët si dhe një kënaqësie në departament, ka një efekt pozitiv më shumë të deklaruar nga personeli i vjetër.

Lidhur me kënaqësinë e profesionistëve shëndetësor në mjedisin institucional, vërehet një diskrepancë e madhe në rezultatet e fituara në mes studimit tim krahasuar me rezultatet e studimit të Universitetit të Romës.

Sa i përket marrëdhënies dhe marrjes së informatës me kohe nga menaxhmenti, 58 (22%) pjesëmarrës janë deklaruar se nuk janë aspak të kënaqur, 73 (27.7 %) pjesëmarrës janë pak të kënaqur, 101 (38.5 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 31 (11.8%) pjesëmarrës janë shumë të kënaqur .

Sipas studimit nga Universiteti i Romës “Vergata Tor”, modeli faktorial lidhur me kënaqësinë dhe menaxhimin (gjërat pozitive apo negative) bazuar në tri referime, vërejmë treguesit negativ: 1) i pari me 15.5% mospërputhje; 2) i dyti me 11.7% mospërputhje; dhe 3) i treti me 10.2% mospërputhje.

Në pyetjen: sa jeni të kënaqur me produktivitetin e takimeve të ekipit, 56 (21.3%) pjesëmarrës janë deklaruar se nuk janë aspak të kënaqur, 68 (25.9 %) pjesëmarrës janë pak të kënaqur, 103 (39.1 %) pjesëmarrës janë të kënaqur, ndërsa 36 (13.7%) pjesëmarrës janë shumë të kënaqur.

Bazuar në studimin nga Universiteti i Romës “Vergata Tor” (Ultrainen et al.) mbështesin hipotezën se puna e mirëqenies së profesionistëve është afër në lidhje me nivelin e bashkëpunimit brenda punës ekipore. Perceptimi në lidhje me efektivitetin organizativ, izolimin, punën rutinë, integritetin dhe punën ekipore të lidhura me treguesit e kënaqësisë drejt menaxhimit të lartë, mund të ndihmojnë në identifikimin e pikave për të vepruar dhe promovuar një mjedis pune të shëndetshëm.

Bazuar në komentet e dala në këtë studim, kemi vërejtur se stafit menaxhues në institucionet shëndetësore nuk i është dhënë roli i duhur (vlen të theksohet pozita menaxheriale në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare). Ata janë të marxhinalizuar nga proceset dhe vendimet e rëndësishme dhe strategjike lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore ose me planet e burimeve njerëzore për institucionet. Ata janë të përkushtuar vetëm për funksionet mbështetëse dhe rutinore. Delegimi dhe miratimi i kompetencave mund të funksionojë në këtë rast dhe përfitimet mund të jenë të prekshme.

Studimi i realizuar në Universitetin e Romës “Vergata Tor”, propozon investim në arsim, kulturë dhe ndjeshmëri, sepse kjo do të thotë se të investuarit në këto drejtime do të ketë reduktim të kostos, njerëzit ndjejnë dhe zgjerohen me anë të qasjes në biznes, njeriu është më pak i “sëmurë”, vuajnë më pak nga stresi dhe janë më të motivuar për të punuar (Bettenardi et al.2008). Vendimtare në këtë kontekst është arsyeja se menaxhimi i vjetër kulturor, nuk duhet të përgjigjet vetëm për rregullat normale, por duhet të përgjigjet edhe për ato organizative, specifikimin e rolit të profesionistit si një vlerë sociale në vetvete, sepse ajo tenton për të kënaqur nevojat e domosdoshme: shëndetin.

Menaxhmenti duhet të përqendrohet në politikat e organizatës që promovon shëndetin, kulturën dhe punën, kështu që do të kishte mundësi kontrolli dhe pjesëmarrje nga punonjësit në përkrahje sociale, plotësimin e nevojave shëndetësore të individit dhe të organizatës.

Ndryshimi i madh qëndron se individit ka të drejtë të gjykojë dhe të matë kënaqësinë, nevojat dhe kushtet e jetesës. Disa studime kanë treguar se kënaqësia e punës së stafit, është një parashikues i fillimit të Sindromit Burnout. Jo për të nënçmuar në këtë fushë stilin e lidhshëm, nëse është i përshtatshëm, promovon kënaqësi më të madhe të punës në mesin e të vjetërve, e cila në mënyrë të pashmangshme do të ketë efekt pozitiv në cilësinë e kujdesit të ofruar nga ana e tyre.

Andaj sipas këtij studimi të paraqitur, kënaqësia në punë rezulton më tepër në efektin negativ, sepse gjendja e stresit, mjedisi punues, burimi i jetës ekonomike, kultura, bëjnë një gamë të gjerë të aktiviteteve zgjedhore që pasurojnë ekzistencën e tyre.

Konkluzione

Konkluzionet e dala nxjerrin në pah shumë gjëra lidhur me bashkëpunimin, komunikimin dhe dialogun që realizohet në mes punonjësve shëndetësorë dhe lidhshëm/menaxhmentit. Profesionistët shëndetësorë së bashku me stafin menaxherial duhet të ndryshojnë në vazhdimësi si përgjigje ndaj kërkesave të kohës me qëllim të përmirësimit të menaxhimit në institucionet shëndetësore.

Bazuar në raportin komunikues dhe informativ në mes punonjësve dhe lidhshëm vërejmë se raporti komunikues nuk qëndron në nivelin adekuat kur shihet se mbi 71% të punonjësve nuk kanë qenë të informuar lidhur me aktivitetin e takimit punues/evolues, shkak ky që lenë të kuptohet që liderët nuk përcjellin informatën në kohë tek punonjësit, ku e tërë kjo rezulton si pasojë e mos komunikimit dhe bashkëpunimit.

Profesionistët shëndetësorë u deklaruan se kanë interesim të madh në fuqizimin e rolit të tyre si dhe mundësinë e diskutimeve dhe sugjerimeve me liderët e tyre. Po ashtu sipas deklarimeve disa menaxher nuk i shtojnë proceset përpara, nuk ofrojnë bashkëpunim, përkrahje dhe nuk janë të gatshëm të ballafaqohen me realitetin që kanë institucionet shëndetësore.

Kërkesat e profesionistëve shëndetësorë ishin që të gjithë punonjësit shëndetësorë dhe jo-shëndetësorë të trajtoheshin për menaxhim, me qëllim të ngritjes së njohurive lidhur me lidhshëm dhe menaxhimin e resurseve njerëzore. Kërkesë tjetër është sigurimi i kushteve të punës dhe mjedisit ku punojnë, stimulimin për punën që realizojnë, bashkëpunim, përkrahje si dhe komunikim dhe dialog me lidhshëm, faktorë këta që do të shtojnë dhe mundësojnë të ndikojnë pozitivisht në ndryshime si dhe në rritjen e cilësisë dhe efikasitetit në punë.

Në këtë studim kemi vërejtur se stafit menaxhues në institucionet shëndetësore nuk i është dhënë roli i duhur (vlen të theksohet pozita menaxheriale në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare).

Bazuar në këtë, mund të konkludojmë se aktualisht sistemi menaxherial shëndetësor dhe sistemi shëndetësor në Kosovë nuk është në nivelin e duhur, pasi që satisfaksioni lidhur me mjedisin institucional punues varet nga shumë faktorë, si ai

financiar, sigurimi shëndetësor dhe ai në punë, kultura në punë, edukimi shëndetësor, arsimimi, respektimi i kodit etik, etj. Përgjegjësit në shëndetësinë kosovare duhet të rishqyrtojnë rolin e menaxherëve, të rrisin kapacitetet dhe të përfshijnë stafin profesional në planifikimin strategjik për institucionet, sepse delegimi dhe miratimi i kompetencave mund të funksionojë në këtë rast dhe përfitimet mund të jenë të prekshme.

Shëndetësisë kosovare i nevojiten ndryshime të domosdoshme që do të sjellin pozitivitet të drejtpërdrejt në menaxhimin e burimeve njerëzore në tri fusha:

Akademike dhe universitare – të shtohet numri i universiteteve me qëllim të studimeve/specializimeve universitare dhe pasuniversitare për burimet njerëzore dhe rritjes së numrit dhe formimit të këtyre kuadrove, pasi që mungojnë në Kosovë.

Politikat publike – të modernizohen ligjet e punës duke patur si qëllim favorizimin e organizatave në aplikimin e teknikave moderne siç është bilanci i kompetencave, trajnimi apo ligje të tjera specifike në zhvillimin e burimeve njerëzore.

Organizative – zhvillimi dhe përsosja e një modeli “referencial” për burimet njerëzore që do të bazohet në një sistem rekrutimi, integrimi, formimi, vlerësimi të performancave, promovimit dhe të zhvillimit të karrierës.

Realizimi i këtyre pikave do të ndikonte pozitivisht në përforcimin e burimeve njerëzore, rritjen e bashkëpunimit dhe lehtësimin në marrjen e vendimeve për ndryshime.

Bibliografia

- Begolli I. 2001. Edukimi Shëndetësorë. Prishtinë
- Carnall C. 1990. Menaxhimi i Ndryshimeve në Organizata. Prentice Hall
- Carnegie D. 2003. Psikologjia e suksesit 3 – Si ta zhvillojmë mjeshtërinë e oratorisë dhe si ta fitoni vetëbesimin. Prishtinë
- Doracak për standarde lidhur me etikën dhe të drejtat e njeriut për punëtorët shëndetësorë të fondacionit për trajnim mjekësor të Komënuellthit, pjesa 3 - www.commat.org
- FRIDOM. 2008. Rishikimi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (Sistemet dhe kapacitetet). Prishtinë
- Gudha A. 2008. Historiku, organizimi dhe menaxhimi i sistemit shëndetësor. Tiranë H.Fayol. 1930.
- Shop Management. New York, Houper Row, fq,21
- Heriz Wehrich & Horold Koontz. 1993. Management A Global Perspective. Copyright McGraw-Hill, Inc New York, fq 4.
- Instituti Kombëtar për Shëndet Publik në Kosovë. Resurset Humane në Shëndetësinë e Kosovës (Sektori Publik). 2011
- James A. F Stoner. 1978. Management. New York, fq 7.
- Jennifer M. George (Texas A&M University), Gareth R. Jones (Texas A&M University) 1996. Organizational Behavior, Understanding and Managing, Copyright by Addison –Wesley Company, Inc. fq.151
- Jimmy Pelter and Andy Dahl. 2009. The relationship between employee satisfaction and hospital patient experiences. University of Wisconsin – Whitewater & Frank Mulhern – Northwestern University.
- Kathleen Huttlinger, Jennifer M. Schaller-Ayers, Bernadette Kenny, James W. Ayers. 2004. Research and collaboration in rural community health .
- Key Findings. 2003. Linking Employee Satisfaction with Productivity, Performance and Customer Satisfaction. Corporate leadership council
- Koliqi H. 1990. Andragogjia. Prishtinë
- Koxhaj A., Tomini F. 2006. Menaxhimi i Komunikimit. Tiranë
- KRCT (QKRMT) & ANTARES. 2011. Shqyrtimi i formes së pëlqimdhënies dhe dokumenteve tjera të hulumtimit. Prishtinë
- Kume V. 2007. Manaxhimi Strategjik. Teori, koncepte, zbatime. Tiranë Ligji për Shëndetësi i Kosovës. 2011
- M.Sieff . 1991. Management. fq 133.
- Mano M. 2001. Së bashku për ndryshimin (analizë). Onufri. Tiranë Meunier
- Pierre J., Peraya D. 2009. Hyrje në teorinë e komunikimit. Tiranë
- Moss Kanter R.1994. Menaxhimi i të mësuarit. Dilemat e punës ekipore. Kapitulli 16. Mabey & Iles.
- MSh & AiK. 2004. Ngritja e cilësisë në praktikën profesionale. Prishtinë
- Pedler M., Burgoyne J. & Boydell. Udhëzues për Menaxherët lidhur me Lidërsipin. Kapitulli 1. Publikuar më 2004 nga Mc Hill G.
- Psarolli Y., Kosta J., Hoxha A., Stratobërdha DH., Hasani V. 2003. Shëndeti Publik. Tiranë
- Ramadani N. 2005. Shëndetësia Publike & Etika. Prishtinë
- Ramosaj B. 2004. Management – Bazate menaxhimit. Universiteti i Prishtinës
- Sili Alessandro. 2010. Doktoraturë në infermier – Cikli XXII. Universiteti i Romës “Verga Tor”. Fakulteti i Mjekësisë dhe Kirurgjisë Strategjia e Zhvillimit të Sistemit Shëndetësorë të Kosovës 2005-2015
- Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2010-2014. Ministria e Shëndetësisë në Kosovë. 2010
- Wilson D. 2003. Kompetenat e Lidërsipit Mjekësor. Qendra për Lidërsip, Universiteti i New York-ut.
- Yorkshire Centre for Health Informatics. LEEDS INSTITUTE OF HEALTH SCIENCES. Overcoming barriers to the use of patient data for Research and Development between the National Health Service and Higher Education. A Briefing Paper for the UK Faculty of Health Informatics March 2009.

PËRJETIMI I MENOPAUZËS TEK FEMRAT SHQIPTARE: ANALIZË E FAKTORËVE NDIKUES

ODETA CACAJ

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Mastër Shkencor: Psikologji Këshillimi

ERIKA MELONASHI

Universiteti Europian i Tiranës, Shkolla Doktorale, UET

ABSTRAKT

Mosha e rritur e mesme përfshin një periudhë jetësore rreth 30 vjeçare (35-65 vjeç) gjatë së cilës ndodhin ndryshime të rëndësishme me natyrë biologjike, konjitive dhe psiko-sociale. Ndryshimi kryesor i kësaj moshe tek femrat, është menopauza. Menopauza është një ngjarje fiziologjike e femrës, që përkon me mbarimin e ciklit menstrual dhe të moshës riprodhuese. Këto ndryshime fiziologjike shoqërohen me pasojë të rëndësishme me natyrë psikologjike dhe sociale. Në fakt përjetimet dhe niveli i intensitetit të shenjave gjatë menopauzës janë eksperiencia individuale dhe kulturore. Për këtë arsye, kjo periudhë tranzicioni është në fokus të studimeve të psikologjisë, mjekësisë, psikiatrisë, antropologjisë dhe të sociologjisë. Studime të shumta kanë treguar se faktorët si mosha, statusi, arsimimi, numri i fëmijëve dhe punësimi ndikojnë në përjetimin e menopauzës. Qëllimi i punimit ishte analiza e përjetimit të menopauzës tek femrat shqiptare. U shqyrtuan 5 hipoteza, të cilat shprehnin lidhjet mes përjetimit të menopauzës dhe moshës, statusit, arsimimit, numrit të fëmijëve si dhe punësimit. Për këtë qëllim u intervistuan 10 femra. Instrumenti matës u ndërtua në formën e një interviste me 14 pyetje, të cilat iu përshtatën pyetjeve të 2 instrumenteve matës: 1. The Woman's Health Questionnaire (WHQ) i ndërtuar nga Hunter (1992) në Mbretërinë e Bashkuar. WHQ është projektuar posaçërisht për të studiuar ndryshimet e mundshme në shëndetin fizik dhe psikologjik si dhe në cilësinë e jetës gjatë menopauzës. Instrumenti 2. The Menopause-Specific Quality of Life (MENQOL), i cili u prezantua si mjet për të vlerësuar shëndetin lidhur me cilësinë e jetës në menopauzë (Hilditch, 1996). Rezultatet kanë treguar se mosha e hershme e menopauzës lidhet me përjetimin më negativ të fenomenit, sesa mosha më e vonë. Gjithashtu, femrat e martuara kanë përjetime më pak negative të simptomave të menopauzës sesa femrat beqare, të ve apo të divorcuara. Një gjetje tjetër ishte se, femrat me arsimim më të lartë i përjetojnë më pak negativisht simptomat e menopauzës sesa ato me arsimim më të ulët. Gjithashtu, femrat me fëmijëri përjetojnë simptomat e menopauzës më pozitivisht sesa ato pa fëmijë. Si dhe, femrat e punësuar i përjetojnë simptomat e menopauzës më pozitivisht sesa femrat e papunësuar. Ky studim është studimi i parë në Shqipëri mbi përjetimin e menopauzës dhe ka implikime të rëndësishme për studime të mëtejshme.

Fjalë kyç: menopauzë, femrat shqiptare, përjetimi, faktorët ndikues

Përkufizime të përgjithshme të menopauzës

Menopauza është një ngjarje fiziologjike e gruas që përkon me mbarimin e ciklit menstrual dhe të moshës riprodhuese. Në menopauzë përfundon aktiviteti i vezoreve, vezoret nuk prodhojnë më estrogenë dhe kemi çrregullim në nivelin e FSH (Hormone folikulo-stimulues: mban nën kontroll folikujt tek femrat dhe ovulacionin në përgjithësi) të hormoneve kryesore femërore (Stewart, 2005).

Mjekët përcaktojnë femra në menopauzë, ato që iu janë ndërprerë menstruacionet për 12 muaj rresht (Stewart, 2005). Fjala 'menopauzë' vjen nga greqishtja ku: 'mens' do të thotë muaj dhe 'pausis' ndërprerje. SWAN (Study of Woman Health Across the Nation, 2009), në bazë të vëzhgimit të komuniteteve multietnike në tranzicion të menopauzës, tregoi se, moshë mesatare e menopauzës natyrale është 51.4 vjeç (Gold, Bromberger & Crawford, 2001). Por sipas studimit që është bërë me 5288 femra, të moshës 30-60 vjeç, në nëntë Vende Evropiane, nga viti 1998 në vitin 2002, moshë mesatare e menopauzës natyrale ishte 54 vjeç (Dratva, Gomez & Schindler, 2009).

Po kështu ICARUS (the Italian Climacteric Research Group Study) një shembull i Rajonit të Europës Jugore, në një studim të kryer në vitin 2000, me një total prej 4300 femra me menopauzë natyrale, gjeti se moshë mesatare e menopauzës ishte 50.9 vjeç. Megjithatë, zakonisht menopauza, jetohej mes moshës 45-55 vjeç (Anderson & Graham, 2002). Menopauza konsiderohet 'prematuro' kur ajo ndodh para moshës 40 vjeçare, dhe 'tardive', kur ajo ndodh pas moshës 55 vjeçare (Rebar, Kelsey & Marcus, 2000).

Menopauza artificiale, sipas Udhëzuesit Merck (2008), mund të ndodh në rastet kur ajo shkaktohet nga heqja kirurgjike e vezoreve, nga një trajtim mjekësor, hormonal, kemioterapi apo nga një faktorë tjetër. *Perimenopauza* është faza ku femrat kalojnë nga jeta riprodhuese në atë jo-riprodhuese. *Postmenopauza* është faza që ndodh pas periudhës menstruale të fundit (Utian, 2001). Në vijim të gjitha stadet e menopauzës do t'i quajmë menopauzë.

Ndryshimet biologjike dhe shenjat e menopauzës

Sipas Udhëzuesit Merck (2012), mbarimi i funksionit të folikujve të vezoreve, që paralajmëron menopauzën, nuk ndodh papritur, por në mënyrë të ngadaltë. Gjatë këtij procesi, numri i folikujve pakësohet në mënyrë progresive dhe si rrjedhojë zvogëlohet prodhimi i hormoneve femërore, estrogeni dhe progesteroni.

Çrregullimi menstrual është shenja më e qartë e kësaj periudhe të tranzicionit, nga moshë e riprodhimit deri në humbjen komplet të kapacitetit riprodhues tek femra. Por me kalimin e kohës për rrjedhojë të rënies në qarkullim të estrogenit dhe progjesteronit të cilët mbahen në nivele të ulëta, do të kemi rënien e nivelit të folikujve dhe me humbjen e folikujve, fillon menopauza e vërtet (Speroff, 2002). Krahas çrregullimit menstrual, mund të shfaqen dhe shenja paralajmëruese të menopauzës si afshe, djersitje natën dhe pagjumësi. Sipas WHO (World Health Organization, 1996), në kuadër të konceptit Perëndimor, shenjat si afshet dhe pagjumësia njihen si të lidhura drejtpërdrejtë me menopauzën.

Krahas çrregullimit të ciklit, me tranzicionin e menopauzës janë të lidhura dhe shfaqja e shenjave, kryesisht të lidhura me kulturën perëndimore (Dennerstein, Dudley & Hopper, 2000). Ndryshimet që mund të ndodhin gjatë menopauzës mund të jenë fiziologjike, psikologjike dhe psiko-sociale.

Ndryshimet fiziologjike mund të përfshijnë: afshe, shtim në peshë, djersitje natën, thatësi vaginale, dhimbje gjoksi, lodhje/ këputje, dhimbje koke, aritmi, ndryshim në rritjen e flokëve, cikël menstrual të çrregullt, cikël menstrual më të shkurtër, cikël menstrual më të gjatë dhe cikël menstrual me pak ose me shumë fluks. Ndryshimet hormonale janë karakterizuar si ndikim i drejtpërdrejtë me çrregullimet e ciklit menstrual. Të dhënat e shumë studimeve kanë treguar përveç çrregullimit të ciklit menstrual, gjatë menopauzës, hormonet ndikojnë dhe në kohëzgjatjen e ciklit dhe në fluksin e gjakderdhjes (Sherman & Korenman, 1975; Randolph, Sowers & Bondarenko, 2004). Por siç është përmendur më lart, sipas WHO shenjat e vërteta të lidhura me humbjen e hormoneve femërore në menopauzë, janë vetëm djersitje natën, thatësi vaginale dhe afshet (Utian, 2001).

Në ndryshimet psikologjike gjatë menopauzës mund të përfshihen: pagjumësi, vështirësi në përqendrim, gjendje shpirtërore negative/depression, nervozizëm, luhatje humori, ankth, probleme me kujtesën, pakënaqësi në jetën personale, humbja e interesit seksual dhe shmangie të intimitetit. Shumë femra të moshës së mesme raportuan shenja të ndryshme (djersitje natën, afshe, thatësi vaginale, pagjumësi, luhatje humori, ndryshime konjitive, dhimbje somatike, cikël menstrual me shumë/pak gjakderdhje, cikël menstrual të gjatë/të shkurtër dhe shenja të humbjes të interesit seksual, por këto ndryshime nuk janë specifike të menopauzës, pasi shumë femra i përjetojnë këto shenja në çdo kohë të jetës së tyre (Dennerstein et al. 2000). Në studimet e kryera në më shumë se një vend, vetëm shenjat si afshe, djersitje natën dhe thatësi vaginale ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme gjatë fazave të tranzicionit të menopauzës (Gold, Sternfeld & Kelsey, 2000).

Në ndryshimet psiko-seksuale gjatë menopauzës mund të përmendim: humbje të interesit seksual si dhe shmangie të intimitetit. Shumë mjekë të klinikave të ndryshme, kanë vënë në dukje faktin, se femrat në menopauzë raportojnë ndryshime në jetën e tyre seksuale. Ndryshimet në funksionin seksual të lidhura me moshën dhe me menopauzën janë të shpeshta. Po ashtu studiues të tjerë konfirmuan ulje të dëshirës seksuale, më pak marrëdhënie seksuale dhe rritje të problemeve me partnerët e tyre gjatë menopauzës (Dennerstein, Dudley & Burger, 2001).

Vështrim ndërkulturor mbi shenjat e menopauzës

Shenjat e menopauzës përjetojnë në të gjitha rajonet e botës, edhe pse mbizotërimi i këtyre shenjave, ka dallime tek femrat me origjinë të ndryshme etnike dhe kulturore (Boulet, Oddens & Lehert 1994; Freeman & Sherif, 2007; Gold et al. 2000). Përjetimi i shenjave dhe shqetësimeve të shkaktuara nga tranzicioni i menopauzës, është treguar, se lidhen me shëndetin femrave në përgjithësi, punësimin e tyre, statusin social-ekonomik, faktorët psiko-social, kulturor si dhe ngjarjet e mëparshme të jetës (Gold, Block & Crawford, 2004; Obermeyer, 2000). Një studim i rëndësishëm është zhvilluar në 2004-2005 në shtatë vende evropiane (Belgjikë, Francë, Gjermani, Vendet e Ulëta, Spanjë, Zvicër dhe Britani e Madhe), duke marrë parasysh kampionin sa më përfaqësues nga moshë, arsimimi dhe shpërndarje gjeografike (Genazzani, Schneider & Panay, 2006). U vëzhgua se shumica e femrave, kishte përjetuar në menopauzë një ose më shumë shenja të menopauzës, dhe 63% e tyre, i vlerësuan këto shenja si të rënda. Po ashtu u vu re se femrat në Britaninë e Madhe raportuan më shumë shenja të përgjithshme dhe të rënda, në krahasim me vendet e tjera evropiane. Shenjat më të shpeshta ishin afshet (74%), pagjumësi (58%), luhatje humori (57%), nervozizëm (53%) dhe humbje të interesit seksual (45%). Gjithashtu shumica e femrave treguan se 'afshet' ishte shenja që kishte prekur më shumë jetën e tyre (48%), duke u pasuar nga pagjumësia (23%) dhe luhatja e humorit (16%). Gati 45% të femrave të intervistuar ndiheshin të ndikuar nga menopauza (33% në Francë dhe 58% në Gjermani) dhe 22% kanë raportuar një rënie në cilësinë e jetës së tyre (16% në Zvicër dhe 30% në Britaninë e Madhe).

Ky kërkim gjithashtu zbuloi, se pothuajse të gjitha femrat me eksperiencë të shenjave të menopauzës, ndihen të prekura nga ajo. Duhet të theksohet edhe fakti se në këtë studim, kishte dallime esenciale midis vendeve, si nga mbizotërimi i shenjave të "rënda" dhe nga impakti i tyre në jetën e përditshme. Për shembull, shumica e femrave në vendet nordike evropiane që kanë raportuar shenja të menopauzës, ndiheshin të prekura në mënyrë të konsiderueshme nga menopauza dhe si rrjedhojë, kishin rënie në cilësinë e jetës së tyre. Kurse në Francë dhe Spanjë, ndikimi i menopauzës ishte në mënyrë të konsiderueshme më i ulët.

Në një studim në SHBA nga SWAN (2013) si dhe nga studimi i kryer nga Gold, Colvin & Avis (2006), tregon se përjetimi i shenjave të menopauzës ndryshon në bazë të etnisë. Afshet dhe djersitjet kanë qenë me këtë përqindje, tek etnitë e ndryshme: Afrikane-Amerikane (46.5%) dhe tek Hispaniket me (45%), më pak e përhapur tek Japoneze-Amerikane (34%) dhe te Kineze-Amerikane (29%) se tek femrat e bardha amerikane (37%).

Një studim tjetër në 12 vende të Amerikës Latine, tregoi se shenjat e menopauzës të përjetuara nga femrat ishin me këtë përqindje: afshet (68%), pagjumësi (68.4%) gjendje depresioni (55.2%) dhe nervozizëm (51.6%) (Chedraui, Blumel & Baron, 2008). Gjithashtu (77%) e femrave në vendet e Amerikës Latine, raportuan dhimbje muskujsh dhe dhimbje të përgjithshme. Po ashtu një tjetër studim në Azi, ka treguar se afshet kanë mbizotëruar më shumë tek femrat në Korenë e Jugut (38.5%), Malajzi (30%) dhe Filipine (30.2%), se sa tek femrat në Hong Kong (10.2%), Indonezi (9.8%), Singapor (14.5%) dhe Tajvan (21.4%) (Boulet et al. 1994). Në Korenë e Jugut kishte raportime dhe të shenjave si: probleme me kujtesën (80.1%), nervozizëm (71%) dhe pagjumësi (68.7%). Në Srilanka raportohen shenja të përgjithshme të menopauzës (55.8%), lodhje/ këputje fizike dhe mendore (53.9%) (Gupta, Sturdee & Hunter, 2006).

Pavarësisht se ndryshimi real në mbizotërimin e shenjave nuk mund të përjashtohet, shumica e ndryshimeve të vëzhguara mund të jenë të lidhura me kulturën, me pritshmëritë e ndryshme mbi menopauzën dhe me përjetimin e shenjave të saj (Melby, 2005). Po kush janë faktorët që ndikojnë në përjetimin e këtyre shenjave?

Faktorët që ndikojnë në përjetimin e shenjave të menopauzës

Mosha

Sipas diskutimit të mësipërm, tek përkufizimet e përgjithshme të menopauzës, në bazë të moshës së caktuar të menopauzës, ka menopauzë në moshë mesatare (45-55 vjeç), menopauzë premature para moshës 40 vjeç dhe menopauzë tardive pas moshës 55 vjeç. Menopauza premature është e lidhur me shenja të shumta të menopauzës, të tilla si afshet, djersitje natën, thatësi vaginale, pagjumësi, humbje të interesit seksual, dhimbje koke, depresion, ankth dhe vështirësi në përqendrim (Burnett, 2001). Afshet në 75% të rasteve të menopauzës premature, kanë tendencë të jenë më të shpeshta dhe më të rënda se tek femrat me menopauzë natyrale (Okeke, Anyaehie & Ezenyeaku, 2013). Në një studim të kryer nga McKinlay, Brambilla & Posner (1992) ka mbledhur informacione se femrat që përjetojnë menopauzë në moshën mesatare, do të shprehin ndjenja pozitive dhe neutrale rreth menopauzës në krahasim me femrat që kanë pasur menopauzë premature.

Një faktor tjetër i lidhur me moshën e menopauzës është fakti se, femrat me menopauzë premature, mund të kenë më shumë frikë për eksperiencën e pashmangshme të menopauzës, në krahasim me femrat më të mëdha në moshë (Eisner & Kelly, 1980). Gjithashtu lidhur me këtë fakt, mund të përjetojnë më shumë shenja paralajmëruese të menopauzës, si rrjedhojë mund të kenë një qëndrim negativ ndaj saj (Wilbur, Miller & Montgomery, 1995). Femrat e reja nuk janë të përgatitura për menopauzën, në qoftë se fillojnë fazën e parë të menopauzës rreth moshës 30 vjeç dhe fazën e dytë rreth moshës 40 vjeç. Ndërsa femrat më të mëdha që fillojnë fazën e parë rreth moshës 40 vjeç dhe fazën e dytë rreth moshës 50 vjeç, mund të kenë më pak prirje për lindjen e fëmijëve (Strauss, 2011). Pra, me shembujt e studimeve të ndryshme, mosha e menopauzës mund të jetë një faktor i mundshëm ndikues në përjetimin e menopauzës.

Statuasi

Statuasi mund të ndikojë në përjetimin e menopauzës. Në një studim në Australi, ankesat psikologjike të tilla si: depresioni, luhatje humori dhe trishtimi, ishin shpesh të lidhura me pakënaqësi në jetën personale të femrave që ishin të ve dhe beqare (Berger, 1999). Në të njëjtin përfundim kishin arritur dhe Dennerstein, Guthrie & Clark, (2004) për faktin se femrat e martuara, kishin një përjetimin më pozitiv të menopauzës, në krahasim me femrat e tjera. Një lidhje tjetër midis statusit martesor dhe përjetimit të menopauzës e sjell Remez (2001) me kërkimin e tij, në lidhje me moshën e menopauzës. Ai arriti në përfundimin se statusi e divorcuar, e ve ose beqare lidhej ngushtë me kalimin e një menopauze më të hershme. Në të njëjtin përfundim ka arritur dhe Gold, Crawford, Avis, Crandall, Matthews, Waetjen, Lee, Thurston, Vuga & Harlow (2013) si dhe Gold et al (2001), se statusi, 'beqare' apo 'e ve' lidhej me faktin e përjetimit të menopauzës më të hershme se te femrat e tjera. Duke u bazuar në këto studime, statusi mund të jetë një faktor i mundshëm ndikues në përjetimin e menopauzës.

Arsimimi

Një faktor tjetër që është i lidhur me përjetimin negativ të menopauzës, është arsimimi i ulët (Remez, 2001). Në një studim në Australi të kryer nga Dennerstein, Smith, Morse, Burger, Green, Hopper & Ryan (1993), u argumentua se femrat që kanë një nivel më të lartë arsimimi, kanë më pak gjasa që të përjetojnë shenjat e menopauzës, në krahasim me femrat me një nivel më të ulët arsimimi. Gjithashtu Schoenaker, Jackson, Rowlands & Mishra (2014) dhe Gold et al (2001), tregoi se rezultatet e një studimi të kryer me femrat që kishin kaluar menopauzën, arsimimi i ulët ishte i lidhur me përjetimin negativ dhe me një moshë më të hershme. Kurse Gold et al (2013) arsimimin e lartë e lidhin, me përjetimin pozitiv të menopauzës në një moshë më të vonë.

Po në të njëjtin rezultat arriti SWAN me studimin e Gold et al (2006), se arsimimi i ulët lidhet më shumë me përjetimin e shenjave të menopauzës si: afshe dhe djersitje natën. Nga ana tjetër gjetjet e një studimi në Tajvan (Cheng, Wang, S., Wang, P. Fuh, 2005) treguan se femrat me arsimi të lartë, shpreheshin se kishin më shumë probleme në menopauzë në krahasim me femrat me nivel të ulët arsimimi. Megjithatë në një studim tjetër të kryer në Kinë (Chen, Voda & Mansfield, 1998) tregoi se pavarësisht kulturës lindore apo perëndimore, femrat me arsim të lartë, mbajnë një qëndrim më pozitiv ndaj menopauzës. Pra duke vëzhguar këto studime, niveli i arsimimit, mund të jetë një faktor i mundshëm në ndikimin e përjetimit të menopauzës.

Numri i Fëmijëve

Historia e riprodhimit tek femra, mund të jetë e rëndësishme në përjetimin e menopauzës. Për shembull, në kulturën meksikane, e cila favorizon të paturit shumë fëmijë, arritja e menopauzës ndihet si lehtësim dhe çlirim (Beyene 1989). Sipas studimit të Remez (2001), femrat që kanë eksperiencë të lindjes së fëmijëve mund të arrijnë më vonë menopauzën natyrale, duke reduktuar më parë ciklet e ovulimit. Po ashtu femrat Japoneze-Amerikane dhe femrat e tjera që kanë lindur fëmijë gjatë jetës së tyre, vonojnë në arritjen e menopauzës natyrale (Strauss, 2011). Gjithashtu Strauss (2011) tregoi se femrat që ishin nëna, e përballonin më mirë menopauzën se sa femrat pa fëmijë. Humbja e fertilitetit për disa femra që nuk kanë qenë nëna mund të sjell problematika të veçanta, lidhur me ndjenjën e humbjes përgjithmonë të mundësisë për të lindur një fëmijë.

Gjithashtu Strauss (2011) tregoi se në rastin e femrave që nuk kanë fëmijë dhe janë beqare, problematikat shtohen në mendimet e tyre, pasi kanë më pak mundësi për t'u lidhur me dikë, për shkak të humbjes së mundësisë riprodhuese. Rrjedhoja e këtyre mendimeve tek femrat pa fëmijë, mund të ndikojë në qëndrimet negative ndaj menopauzës dhe në përjetimin e shenjave të saj. Pra siç mund të shohim nga studimet, të paturit fëmijë apo jo, mund të jetë një faktor i mundshëm ndikues në përjetimin e menopauzës.

Punësimi

Disa studiues kanë treguar se, duke pasur role të shumta në jetë, si punësimi jashtë shtëpisë, femrat mund të lehtësohen nga eksperiencia e shenjave të menopauzës, gjithashtu mund të sjellë rritje në ndjenjat e vetë-respektit dhe vetë-efikasitetit (Strauss 2011). Por në të njëjtën kohë këto femra mund të kenë më shumë frikë në ndikimin dhe ndërhyrjen e shenjave të menopauzës në efikasitetin e punës dhe përkeqësimin e performancës së tyre në punë, për shkak të vështirësisë së menaxhimit të këtyre shenjave.

Gjithashtu sipas Strauss (2011), puna luante një rol të rëndësishëm te femrat që nuk ishin nëna dhe ishin në menopauzë. Puna sipas këtij studimi, plotësonte rolet e munguara tek këto femra dhe u siguronte atyre identitet social. Sipas Gold et al (2001) tregoi se femrat që nuk ishin të punësuar, e arrinin më shpejt menopauzën natyrale se femrat që ishin të punësuar. Në të njëjtin përfundim ka arritur dhe studimi i Remez (2001) dhe Schoenaker et al (2014), femrat që nuk ishin të punësuar e kalonin më shpejt në moshë menopauzën natyrale. Pra, studimet tregojnë se punësimi tek femrat në menopauzë mund të jetë një faktorë i mundshëm ndikues në përjetimin e menopauzës.

Metodologjia

Qëllimi i këtij studimi është: analiza e përjetimit të menopauzës tek femrat shqiptare.

Objektivi i këtij studimi është: analiza e faktorëve që ndikojnë në përjetimin e menopauzës tek femrat shqiptare, duke

përfshirë moshën, statusin, arsimimin, numrin e fëmijëve si dhe punësimin.

Pyetja kërkimore që ngrihet në këtë studim është: si ndikon moshja, statusi, arsimimi, numri i fëmijëve dhe punësimi në përjetimin e menopauzës tek femrat shqiptare?

Hipotezat që ngrihen nga ky punim janë pesë.

Hipoteza 1: Moshja e hershme e menopauzës lidhet me përjetimin më negativ të fenomenit sesa moshja mesatare (e vonë).

Hipoteza 2: Femrat e martuara kanë përjetime më pak negative të simptomave të menopauzës sesa femrat beqare, të ve apo të divorcuara.

Hipoteza 3: Femrat me arsimim më të lartë i përjetojnë më pak negativisht simptomat e menopauzës sesa ato me arsimim më të ulët.

Hipoteza 4: Femrat me fëmijë i përjetojnë simptomat e menopauzës më pozitivisht sesa ato pa fëmijë.

Hipoteza 5: Femrat e punësuara i përjetojnë simptomat e menopauzës më pozitivisht sesa femrat e papunësuara.

Variabilet që janë marrë në analizë për hipotezat janë: variabilet e pavarur: moshja, statusi, arsimimi, numri i fëmijëve dhe punësimi dhe variabël i varur: përjetimi i menopauzës.

Analiza qendrore e këtij punimi është realizuar në bazë të qasjes metodologjike cilësore. Duke u bazuar në qasjen metodologjike cilësore, ky punim përdor metodën e intervistës gjysmë të strukturuar, me qëllim që rezultatet e kërkimit të jenë sa më përfshirëse. Gjithashtu, metodologjia e përdorur është bazuar në të dhëna parësore që u referohen 10 intervistave si dhe në të dhëna dytësore, si libra, artikuj dhe kryesisht botime të studimeve shkencore, të cilat janë përdorur sipas qëllimeve specifike të punimit.

Pjesëmarrësit

Pjesëmarrësit në këtë studim ishin 10 femra, në moshën e mesme të rritur, të cilat e kishin arritur menopauzën dhe përfshinin segmentin e moshës 39-65 vjeç, moshja mesatare është 55.2 vjeç. Kampioni i pjesëmarrësve ishte një kampionim konvenience, me qëllimin specifik të studimit. Kriteri seleksionues u bazua në pesë variabilet e pavarur të hipotezave si: *mosha e menopauzës*: menopauzë premature dhe menopauzë në moshë mesatare; *statusi*: të martuara, të ve dhe beqare; *arsimimi*: arsimim 8-vjeçar, arsimim të mesëm dhe arsimim të lartë; *numri i fëmijëve*: femra pa fëmijë dhe femra me fëmijë si dhe *punësimi*: të punësuara dhe jo të punësuara. Nga 10 femra të intervistuar për moshën kemi: 2 femra me menopauzë premature dhe 8 femra me menopauzë në moshë mesatare. Për sa i përket statusit, 7 femra ishin të martuara, 2 femra ishin të ve dhe 1 femër ishte beqare. Gjithashtu për arsimimin, 3 kishin arsimim të mesëm, 1 kishte arsimim 8-vjeçar dhe 6 ishin me arsimim të lartë. Për sa i përket numrit të fëmijëve, 3 femra nuk kishin fëmijë, 7 ishin me fëmijë. Gjithashtu për punësimin, 7 ishin të punësuara dhe 3 nuk ishin punësuara.

Procedura

Procedura që është ndjekur në këtë studim, ishte në bazë të kampionimit të konvencencës. Pjesëmarrësit u kontaktuan telefonikisht dhe u informuan mbi temën, qëllimin dhe objektivat e studimit si dhe mbi të drejtën e konfidencialitetit dhe anonimitetit të tyre. Pas marrjes të aprovimit të informuar dhe pëlqimit të publikimit të të dhënave, intervista u zhvillua në ambientet e shtëpisë së tyre. Zgjatja kohore e intervistës ishte 10-15 min. Të gjithë pjesëmarrësit e intervistuar shkuan deri në fund të procesit. Të gjitha intervistat u zhvilluan në një hark kohor prej 7 ditësh.

Instrumentet

Në mungesë të pyetësorëve të standardizuar në Shqipëri, për qëllimin e këtij studimi, u përdorën 2 instrumente matës. 1. The Woman's Health Questionnaire (WHQ) i ndërtuar nga Hunter (1992) në Mbretërinë e Bashkuar. Ky instrument është projektuar për të vlerësuar një gamë të gjerë të shenjave fizike e emocionale, si dhe përjetimeve të eksperiencave të femrave në moshën e mesme të rritur (45-65 vjeç). WHQ është projektuar posaçërisht për të studiuar ndryshimet e mundshme në shëndetin fizik dhe psikologjik si dhe në cilësinë e jetës gjatë menopauzës (Hunter, 1992). Ky instrument matës është përkthyer në 27 gjuhë të botës dhe vlefshmëria e këtij instrumenti matës, vjen nga një sërë studimesh (Genazzani, Nicolucci & Campagnoli, 2002; Hunter & O'Dea 2001; Slaven & Lee 1997; Wool, Cerutti & Marquis, 2000; Wiklund, Karlberg & Lindgren, 1993; Hunter, 2000).

Pyetjet e këtij instrumenti matës janë të ndarë në 9 çështje: gjendja depresive, shenja somatike, kujtesa/përqendrimi, afshe/djersitje natën, ankth/frikë, sjellja seksuale, problemet e gjumit, shenja menstruale si dhe tërheqja. Intervista u përshtat këtij instrumenti matës për listën e shenjave të menopauzës, por pyetjet u modifikuan sipas qëllimeve të kufizuara të këtij studimi.

Instrumenti 2. The Menopause-Specific Quality of Life (MENQOL), i cili u prezantua si mjet për të vlerësuar shëndetin lidhur me cilësinë e jetës në menopauzë (Hilditch, Lewis, Peter, Van Maris & Ross, 1996) MENQOL, supozon, se kushtet si

menopauza, mund të prodhojnë shenja që mund të shqetësojnë anën emocionale, fizike dhe sociale të një individi. Vlefshmëria e këtij instrumenti tregohet nga një sërë studimesh (Lewis, Hilditch&Wong, 2005; Knobf, 2001; Carpenter&Andrykowski 1999; Tchen, Juffs, Downie, Yi, Hu & Chemerynsky, 2003). Instrumenti matës MENQOL është i ndarë në 29 pyetje me format të shkallës Likert. Me anë të 29 pyetjeve vlerësohet impakti që kanë shenjat fiziologjike, psiko-sociale, seksuale dhe vazo-motore të menopauzës, në cilësinë e jetës. Intervista i është përshtatur këtij instrumenti matës në pyetjet që ishin të lidhura me ndikimin e shenjave të menopauzës në cilësinë e jetës.

Intervista përfundimtare u ndërtua mbi 15 pyetje. Pyetjet ishin pyetje dikotomike, filtruese, me alternativa të shumëfishta, të shkallës Likert dhe pyetje të hapura. Për shembull, pyetjet dikotomike dhe filtruese, synonin mbledhjen e informacionit demografik si: moshë, statusi, arsimimi, numri i fëmijëve dhe punësimi. Pyetjet e hapura synonin mbledhjen e informacionit të përjetimeve të ndryshme mbi menopauzën. Pyetjet me alternativa të shumëfishta synonin raportimin e shenjave të menopauzës. Pyetjet e shkallës Likert (aspak, pak, mesatarisht, shumë) synonin raportimin e ndikimit të shenjave të menopauzës në cilësinë e jetës.

Pyetjet e intervistës u përkthyen nga dy persona dhe versionet u krahasuan për përpunueshmërinë e përkthimit. Intervista është pilotuar tek dy individë për kuptueshmërinë e intervistës.

Kufizimet e studimit

Ky studim bazohet në qasjen metodologjike cilësore me anë të intervistës të gjysmë të strukturuar, me qëllim përshkrues, por jo përgjithësues. Numri i intervistave është një tjetër kufizim për përgjithësim. Mungesa e studimeve në Shqipëri mbi menopauzën, sjell po ashtu një kufizim për krahasimin e gjetjeve të këtij studimi. Pavarësisht këtyre kufizimeve, metoda e përdorur ishte më e përshtatshme për tematikën specifike. Studime të mëtejshme sasiore mund të replikojnë gjetjet e këtij studimi në nivel përfaqësues.

Rezultate dhe Diskutime

Tabela e mëposhtme paraqet gjeneralitetet e femrave që janë intervistuar, këto gjeneralitete janë njëkohësisht dhe variabilet e këtij punimi.

TABELA 1. VARIABILET E STUDIMIT: MOSHA E MENOPAUZËS, STATUSI, ARSIMIMI, NUMRI I FËMIJËVE DHE PUNËSIMI.

Rastet	Moshë	Moshë e menopauzës	Statusi	Arsimimi	Numri i fëmijëve	Punësimi
Rasti 1	61 vjeç	55 vjeç	E martuar	I mesëm	0	Shtëpiake
Rasti 2	63 vjeç	45 vjeç	E ve	I lartë	2	Psikiatre
Rasti 3	57 vjeç	54 vjeç	E martuar	I lartë	2	Bibliotekare
Rasti 4	54 vjeç	42 vjeç	E martuar	I lartë	2	Nëpunëse
Rasti 5	65 vjeç	40 vjeç	E ve	8-vjeçar	2	Pensioniste
Rasti 6	39 vjeç	38 vjeç	E martuar	I lartë	3	Nëpunëse
Rasti 7	48 vjeç	47 vjeç	Beqare	I lartë	0	E papunë
Rasti 8	59 vjeç	52 vjeç	E martuar	I lartë	2	Farmaciste
Rasti 9	49 vjeç	47 vjeç	E martuar	I mesëm	0	Operatore
Rasti 10	57 vjeç	50 vjeç	E martuar	I mesëm	2	Rrobaqepëse

Hipoteza 1: Moshë e hershme e menopauzës lidhet me përjetimin më negativ të fenomenit sesa moshë mesatare (e vonë). Rezultatet e këtij studimi tregojnë se nga 10 femra të intervistuar janë: 8 me menopauzë në moshë mesatare dhe 2 me menopauzë premature. Studimet kanë treguar se, menopauza premature, është e lidhur me përjetimin e shenjave të shumta të menopauzës (ankth, depresion, djersitje natën, thatësi vaginale etj) (Burnett et al. 2001). Afshet në (75%) të rasteve tek femrat me menopauzë premature, kanë tendencë të jenë më të shpeshta e më të rënda se tek femrat me menopauzë mesatare natyrale (Okeke et al. 2013).

Gjithashtu, menopauza premature është e lidhur, me qëndrimin dhe përjetimin negativ të menopauzës, në krahasim të femrave me menopauzë në moshë mesatare. (McKinlay et al 1992).

Për të ilustruar mbështetjen e kësaj hipoteze, nga të dhënat e studimit, marrim në shqyrtim, rastet 5 dhe 6 me menopauzë premature dhe rastet 3 dhe 10 me menopauzë në moshë mesatare.

Menopauzë premature

Rasti 5 (38 vjeç) dhe rasti 6 (40 vjeç). Në të dyja rastet ka përjetim negativ të ciklit të parë menstrual dhe të përfundimit të ciklit, për më tepër rasti 5 i ka përjetuar me gjendje ankthi, stresi dhe me emocion. Shenjat e menopauzës: rasti 5 12 shenja dhe rasti 6 20 shenja, si dhe shtoi aritmi dhe dhimbje gjoksi. Duhet të theksojmë se në të dyja rastet, ka gjendje shpirtërore negative, depresion dhe ankth. Vihet re, se këto shenja kanë ndikuar cilësinë e jetës së tyre. Marrëdhëniet familjare ishin

ndikuar mesatarisht në rastin 5 dhe shumë në rastin 6. Aktivitetet e jetës së përditshme ishin ndikuar pak në rastin 5, dhe shumë në rastin 6. Marrëdhëniet bashkëshortore dhe përgjegjësitë në shtëpi ishin ndikuar mesatarisht në rastin 6. Gjithashtu, rasti 6 shikonte shumë aspekte të jetës me negativitet pas menopauzës..

Menopauzë në moshë mesatare

Rasti 3 (54-vjeç) dhe 10 (50- vjeç). Vihet re se përjetimi i ciklit të parë tek këto dy raste, ishte normal, madje në rastin 3 kishte kuriozitet. Kurse, përjetimi i përfundimit të ciklit ishte pozitive dhe normal, pa negativitet. Të dyja rastet, kanë përjetuar 3 shenja të menopauzës dhe këto shenja nuk kishin ndikuar në cilësinë e jetës së tyre, as pas menopauzës.

Pra duke u bazuar në analizën e këtyre rasteve mund të vërehet se, në rastet e menopauzës premature ka një ndjenjë negative të përjetimit të menopauzës, në krahasim me dy rastet e tjera që janë pozitive e neutrale. Tek rastet e menopauzës premature ka dhe mbizotërim të shenjave të menopauzës, në krahasim me dy rastet e tjera. Ndikimi i këtyre shenjave në cilësinë e jetës tregon rëndësën e tyre, e kundërta tek dy rastet e tjera, ku shenjat nuk kishin ndikuar cilësinë e jetës së tyre. Duke u bazuar dhe në gjetjet, pohimet e studimeve të tjera dhe në këtë analizë të këtyre rasteve, mund të thuhet, se hipoteza 1 vërtetohet: Moshë e hershme e menopauzës lidhet me përjetimin më negativ të fenomenit sesa moshë mesatare (e vonë).

Hipoteza 2:Femrat e martuara kanë përjetime më pak negative të simptomave të menopauzës sesa femrat beqare, të ve apo të divorcuara.

Rezultatet e studimit tregojnë se nga 10 femra të intervistuar: 7 femra janë të martuara, 2 të ve dhe 1 beqare. Studimet kanë treguar se statusi i të qenit ‘beqare’ dhe ‘e ve’ lidhet me depresionin, luhatje humori, trishtimin dhe me pakënaqësi në jetën personale (Berger, 1999). Gjetjet e studimeve të tjera tregojnë, se statusi e ve, beqare ose e divorcuar, lidhet ngushtë me kalimin e një menopauze më të hershme (Remez 2001, Gold et al. 2001). Statusi i femrave të martuara lidhet me përjetimin pozitiv të menopauzës, në krahasim me femrat beqare dhe të ve (Dennerstein et al. 1994) .

Për të ilustruar mbështetjen e kësaj hipoteze, nga të dhënat e studimit, marrim në shqyrtim, rastet 2, 5 dhe 7 me status ‘të ve’ dhe ‘beqare’, si dhe rastet 4 dhe 8 me status ‘të martuara’.

Statusi: e ve/beqare

Rasti 2 (e ve), 5 (e ve) dhe 7 (beqare). Rasti 2 kishte shumë pak informacion mbi ciklin e parë menstrual dhe nuk u shpreh shumë, rasti 7 ishte pozitive, kurse rasti 5 përjetimin e ciklit të parë e kishte negativ. Moshë e menopauzës në secilin rast ishte: rasti 2 45 vjeç, rasti 5 40 vjeç, dhe rasti 7 47 vjeç. Të treja rastet e kanë përjetuar me gjendje shpirtërore negative/depresion dhe shumë keq. Rasti 2 përjetoi 8 shenja të menopauzës, rasti 5 12 shenja, 7 12 shenja dhe shtoi melankoli. Këto shenja kishin ndikuar në cilësinë e jetës së tyre, saktësisht: efikasiteti i punës ishte ndikuar shumë në rastin 2, marrëdhëniet në familje ishin ndikuar mesatarisht në rastin 5, aktivitetet e jetës së përditshme ishin ndikuar pak në rastin 5 dhe mesatarisht në rastin 7. Përgjegjësitë në shtëpi ishin ndikuar mesatarisht në rastin 7 kurse marrëdhëniet me kolegët ishin ndikuar pak. Rasti 7, gjithashtu, u shpreh se kishte humbur mundësinë e të qenit nënë me menopauzën, për më tepër ajo nuk kërkonte më lidhje ndërpersonale intime pas menopauzës. Duhet të theksohet fakti që të treja rastet kanë ankth dhe gjendje shpirtërore negative/depresion, në raportimin e shenjave të menopauzës.

Statusi: të martuara

Rasti 4 dhe rastin 8. Vihet re të dyja rastet nuk kishin informacion për ciklin e parë menstrual, prandaj nuk u shprehën shumë, përveçse kuriozitet në rastin 4. Për mbarimin e ciklit të parë menstrual rasti 4 ndihej neutrale dhe e qetë, kurse rasti 8 e lehtësuar. Moshë e menopauzës ishte në rastin 4 42 vjeç dhe në rastin 8 52 vjeç. Shenjat e raportuara të menopauzës ishin: rasti 4 5 shenja dhe rasti 8 15 shenja si dhe dhimbje gjoksi dhe osteoporozë. Si në rastin 4 dhe 8 ndër shenjat e raportuara ishte ankthi. Në të dyja rastet shenjat, nuk kishin ndikuar aspak cilësinë e jetës së tyre, gjatë dhe pas menopauzës.

Duke u bazuar në analizën e këtyre rasteve vërehet se: dy nga 3 rastet e para (të ve dhe beqare) kishin gjendje shpirtërore negative/depresion në përjetimin e menopauzës, në krahasim me femrat e martuara. Të treja rastet 2, 5 dhe 7 kanë raportuar një sërë shenjash të menopauzës dhe ndër tyre, ankth dhe gjendje shpirtërore negative/depresion. Vihet re një moshë më e hershme e menopauzës natyrale tek rastet 2, 5 dhe 7. Po ashtu, në dy rastet 4 dhe 8, ka një sërë shenjash të raportuara, por në krahasim me tre rastet e para, nuk kanë ndikuar cilësinë e jetës së tyre. Duke u bazuar në gjetjet e studimeve dhe në rezultatin e këtyre rasteve, themi se hipoteza 2 vërtetohet: Femrat e martuara kanë përjetime më pak negative të simptomave të menopauzës sesa femrat beqare, të ve apo të divorcuara

Hipoteza 3: Femrat me arsimim më të lartë i përjetojnë për pak negativisht simptomat e menopauzës sesa ato me arsimim më të ulët.

Rezultatet e studimit treguan se nga 10 femra të intervistuar janë: 6 me arsimim të lartë, 3 me arsimim të mesëm dhe 1 me arsimim 8-vjeçar. Një studim në Australi, argumentoi se femrat me arsimim të lartë, kanë më pak gjasa të përjetojnë shenjat e menopauzës (Dennerstein et al. 1993). Gjithashtu qëndrimi dhe përjetimi pozitiv i menopauzës lidhet me arsimimin e lartë (Chen et al. 1998).

Për të ilustruar mbështetjen e kësaj hipoteze, nga të dhënat e studimit, marrim në shqyrtim, rastet 5 dhe 9 me arsimim të ulët dhe rastet 2 dhe 3 me arsimim të lartë.

Arsimim më i ulët

Rasti 5 (arsimim 8-vjeçar) dhe 9 (arsimim i mesëm). Të dyja rastet nuk kishin informacion mbi ciklin e parë dhe nuk u shprehën shumë. Vihet re se, qëndrimi dhe përjetimi ndaj menopauzës ka qenë negativ dhe me nervozitet tek të dy rastet. Rasti 5 nuk kishte marrë informacion mbi menopauzën, kurse rasti 9 kishte marrë informacion nga Masedia.

Shenjat në menopauzë ishin: rasti 5 12 shenja, rasti 9 15 shenja shtoi aritmi dhe qarje vazhdimisht. Marrëdhënia familjare është ndikuar mesatarisht në rastin 9. Marrëdhënia bashkëshortore ishte ndikuar mesatarisht tek dy rastet, kurse aktivitetet e jetës së përditshme ishin ndikuar pak në rastin 5.

Arsimim i lartë

Nëse marrim në konsideratë rastet 2 dhe 3 vihet re se të dyja rastet nuk kanë pasur informacion mbi ciklin e parë menstrual, megjithatë rasti 3 ishte kurioze. Përfundimi i ciklit menstrual u përjetua me gjendje negative/depresive në rastin 2, kurse në rastin 3 ishte krejt normal. Në të dyja rastet informacioni mbi menopauzën ishte marrë nga mjekët. Shenjat e menopauzës ishin: në rastin 2 8 shenja dhe në rastin 3 3 shenja. Në rastin 2 këto shenja kishin ndikuar shumë në efikasitetin e punës kurse rast 3 aspak në cilësinë e jetës. Megjithatë këto shenja në të dyja rastet nuk kishin ndikuar në cilësinë e jetës pas menopauzës.

Nga rezultatet e rasteve, kemi një ndryshim në përjetimin e menopauzës tek femrat me arsimim të lartë dhe ato me arsimim më të ulët. Një ndryshim tjetër që është i rëndësishëm, ishte informacioni i marrë mbi menopauzën. Në rastet e femrave me arsimim të ulët, informacioni mungonte ose ishte marrë nga mediat, kurse në rastet e femrave me arsimim të lartë, informacioni ishte marrë nga mjekët. Vërtet në të gjitha rastet kemi përjetim të shenjave të menopauzës, por në rastet e femrave me arsimim të ulët ka mbizotërim më të theksuar të këtyre shenjave, siç tregonin gjetjet e Gold et al (2001) dhe Chen et al (1998). Gjithashtu tek femrat me arsimim të ulët, ka një ndikim më të ndjeshëm në cilësinë e jetës, se tek femrat me arsimim të lartë. Megjithatë, rasti 2 është i veçantë, për faktin se ajo është e ve dhe përjetimi i saj nuk mund të përcaktohet saktësisht nga se ndikohet, kjo lihet për diskutim në studimet e ardhshme. Pavarësisht, duke u bazuar në gjetjet e studimeve të ndryshme dhe në rezultatet e këtij studimi, hipoteza 3 vërtetohet se: Femrat me arsimim më të lartë i përjetojnë për pak negativisht simptomat e menopauzës sesa ato me arsimim më të ulët

Hipoteza 4: Femrat me fëmijë i përjetojnë simptomat e menopauzës më pozitivisht sesa ato pa fëmijë.

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se nga 10 femra të intervistuar janë: 7 femra me fëmijë dhe 3 pa fëmijë. Gjetjet e studimeve kanë treguar se: femrat me fëmijë e përjetojnë me lehtësim dhe çlirim menopauzën (Beyene, 1989). Një studim tjetër i Strauss (2001), tregoi se femrat që kishin fëmijë e përballonin më mirë menopauzën se ato që nuk kishin fëmijë. Ky studim tregoi gjithashtu se femrat pa fëmijë kanë qëndrime negative ndaj menopauzës, meqenëse ato humbasin përfundimisht mundësinë për t'u bërë nëna. Mendimi për humbjen e mundësisë reflektohej në përjetimin e shenjave të menopauzës dhe ndikimin e tyre në cilësinë e jetës. Për të ilustruar mbështetjen e kësaj hipoteze, nga të dhënat e studimit, marrim në shqyrtim rastet 1, 7 dhe 9 që janë pa fëmijë dhe rastet 3, 4 dhe 8 që janë me fëmijë.

Femra pa fëmijë

Në rastet 1, 7 dhe 9, cikli i parë menstrual është përjetuar me ndrojtje, i paditur dhe neutral. Përjetimi i përfundimit të ciklit, në tre rastet ka qenë negativ, me nervozitet dhe me keqardhje. Shenjat e menopauzës ishin: rasti 1 8 shenja, rasti 7 12 shenja dhe melankoli dhe rasti 9 15 shenja, shtoi aritmi dhe qarje të vazhdueshme. Këto shenja kishin ndikuar në cilësinë e jetës. Marrëdhënia me kolegët ishte ndikuar pak nga rasti 7. Marrëdhënia familjare ishte ndikuar pak në rastin 1 dhe shumë në rastin 9. Marrëdhënia bashkëshortore ishte ndikuar pak në rastin 1, mesatarisht në rastin 9. Përgjegjësitë në shtëpi dhe aktivitetet e jetës së përditshme ishin ndikuar mesatarisht në rastin 7.

Femra me fëmijë

Nëse marrim në konsideratë rastet 3, 4, dhe 8. Vihet re se përjetimi i ciklit të parë menstrual, ka qenë kurioziteti, nga mungesa e informacionit. Përfundimi i ciklit menstrual, është përjetuar në mënyrë të qetë, normale dhe me lehtësim, tek të tre rastet. Shenjat e menopauzës ishin: në rastin 3 3 shenja, rasti 4 5 shenja dhe rasti 8 15 shenja, shtoi dhimbje gjoksi dhe osteoporozë. Pavarësisht se ka prani të shenjave të menopauzës, ato nuk kanë ndikuar aspak në cilësinë e jetës së tre rasteve.

Nga rezultatet e rasteve, vihet re se ka një ndjenjë pozitive ndaj menopauzës tek femrat me fëmijë se sa tek ato pa fëmijë, të cilat kishin përjetuar qarje të vazhdueshme, gjendje shpirtërore negative/depression dhe keqardhje për përfundimin e ciklit menstrual. Pra, vërehet një përbalim më pozitiv të menopauzës tek femrat me fëmijë në krahasim me ato pa fëmijë. Duke u bazuar dhe tek arritjet e studimeve të tjera, hipoteza 4 vërtetohet se: Femrat me fëmijë i përjetojnë simptomat e menopauzës më pozitivisht sesa ato pa fëmijë. Por megjithatë duhet patur parasysh se rastet që janë shqyrtuar në këtë hipotezë, janë përdorur edhe për faktorë të tjerë në hipotezat e tjera, për shkak të faktorëve përcaktues demografikë të tyre.

Hipoteza 5: Femrat e punësuara i përjetojnë simptomat e menopauzës më pozitivisht sesa femrat e papunësuara.

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se nga 10 femra të intervistuar janë: 7 femra të punësuara, 2 jo të punësuara dhe 1 në pension. Studimet kanë treguar se femrat e punësuara jashtë shtëpisë, lehtësohen nga eksperiencia e shenjave të menopauzës si dhe kanë një rritje të vetë-efikasitetit dhe vetë-vlerësimit në krahasim me femrat të papunësuara (Strauss, 2011).

Për të ilustruar mbështetjen e kësaj hipoteze, nga të dhënat e studimit, marrim në shqyrtim, rastet 1 dhe 7 që janë papunë dhe rastet 6 dhe 10 që janë të punësuara.

Femra të papunësuara

Në rastin 1 për përjetimin e ciklit të parë menstrual nuk u shpreh shumë, kurse për rastin 7 ishte negativ. Përfundimi i ciklit menstrual ishte negativ për të dy rastet. Shenjat e raportuara të menopauzës janë: rasti 1 8 shenja dhe rasti 7 12 shenja shtoi melankoli. Marrëdhënia bashkëshortore dhe familjare u ndikuan pak në rastin 1. Aktivitetet e jetës së përditshme dhe përgjegjësitë në shtëpi u ndikuan mesatarisht në rastin 7, kurse marrëdhëniet me kolegët u ndikuan pak.

Femra të punësuara

Marrim në konsideratë rastin 6 dhe 10 që janë në punë. Rasti 6, ciklin e parë menstrual e ka përjetuar me ankth dhe gjendje negative, kurse rasti 10 ndihej krejt normale. Përfundimin e ciklit menstrual rasti 6, e kishte përjetuar me ankth, stres

dhe me emocion, kurse rasti 10 ishte pozitive. Shenjat e raportuara të menopauzës ishin: në rastin 6 20 shenja shtoi dhimbje gjoksi dhe aritmi, në rastin 10 3 shenja. Marrëdhënia familjare dhe aktivitetet e jetës së përditshme ishin ndikuar shumë në rastin 6, kurse marrëdhënia bashkëshortore dhe përgjegjësitë në shtëpi mesatarisht. Rasti 10 nuk ishte ndikuar në cilësinë e jetës.

Nga rezultatet e rasteve, vihet re se, rastet 1 dhe 7 që s'janë të punësuara kanë një përjetim dhe qëndrim negativ ndaj menopauzës. Përjetimi i një sërë shenjash të menopauzës tek të dyja rastet ndikuan cilësinë e jetës së tyre. Kjo shpjegon faktin e rëndësës së këtyre shenjave. Rasti 10 që ishte e punësuar, kishte një qëndrim normal dhe pozitiv ndaj menopauzës dhe cilësia e jetës së saj s'ishte ndikuar nga shenjat e menopauzës. Vihet re se rasti 6 që ishte e punësuar, qëndrimet dhe përjetimi ndaj menopauzës i kishte negative, me ankth dhe emocione. Cilësia e jetës ishte ndikuar shumë nga shenjat e shumta të menopauzës. Për rastin 1 dhe 7 që nuk ishin të punësuara hipoteza jonë vërtetohet. Kurse në rastet e femrave të punësuara, rasti 6 përbën një përjashtim, pasi ky rast nuk mbështet tezhën tonë. Informacioni demografik i këtij rasti është: e martuar, arsimim të lartë dhe punon, gjë që do të jepte përjetime pozitive, por moshë e saj e menopauzës ishte 38 vjeç. Me këtë rast përjashtimor, përforcohet më tepër hipoteza 1: Moshë e hershme e menopauzës lidhet me përjetimin më negativ të fenomenit sesa moshë mesatare (e vonë).

Konkluzione dhe Rekomandimet

Qëllimi i këtij studimi ishte: Analiza e përjetimit të menopauzës tek femrat shqiptare. për këtë qëllim u konsideruan pesë faktorë: moshë e menopauzës, statusi, arsimimi, numri i fëmijëve si dhe punësimi. Rezultatet e këtij studimi vërtetuan hipotezat: Gjithsesi, është e vështirë që këto rezultate të përgjithësohen me këtë studim. Për këtë qëllim duhen kryer edhe studime sasiore. Gjithashtu, ndikimi i më shumë se një faktor, nuk lejon për përfundime përgjithësuere në lidhje me rëndësinë e secilit faktor në veçanti. Për hipotezën 1, moshë premature e menopauzës lidhet me: statusin, arsimimin, me numrin e fëmijëve dhe me punësimin. Për këtë arsye gjetjet e këtij studimi nuk mund të jenë konkluzive në lidhje me ndikimin individual të secilit faktor. Ky studim ka kontributin e vet në fushë, duke qenë se është i pari studim në kuadrin psikologjik të përjetimit të menopauzës. Pavarësisht problematikave, gjetjet e këtij studimi në fjalë lejojnë disa rekomandime për studime të mëtejshme. Studimet sasiore mund të hedhin dritë mbi nivelet e përjetimit të simptomave të menopauzës dhe faktorëve ndikues me një kampion përfaqësues popullate. Gjithashtu rëndësi e veçantë i duhet kushtuar raportimeve të niveleve të ankthit dhe depresionit, të cilat mund të konsiderohen si variabla të veçanta që maten në studime të mëtejshme.

Bibliografia

- Avis NE, Brockwell S, Randolph JF Jr, Shen S, Cain VS, Ory M, et al. (2009) *Longitudinal changes in sexual functioning as women transition through menopause*; results from the study of Women's Health Across the Nation. *Menopause*;16:442–52.
- Avis, N. E., Stellato, R., Crawford, S. (2000) Is there an association between menopause status and sexual functioning? *Menopause*, 7, 297–309.
- Anderson, D., Graham, V. (2002) *Your Menopausa Made Simple Program*, Australia: Allen & Win.
- Berger, K.S. (2008) *The developing person through the lifespan*, New York: Worth Publishers.
- Berger, G.E. (1999) *Menopause and Culture*, London: Pluto Press.
- Beyene, Y. (1989) *From Menarche to menopause: Reproductive lives of peasant women in two cultures*. Albany, NY: State University of New York Press.
- Boulet, M. J., Oddens, B. J., Leher, P. (1994) Climacteric and menopause in seven Southeast Asian countries. *Maturitas*, 19, 157–176.
- Burnett, A. (2001) *Clinical Obstetrics and Gynecology: A problem-based Approach*. 1st edition. Massachusetts: Blackwell Science Inc, *Menopause*, 269–274.
- Carpenter, J. S., Andrykowski, (1999) M. A. Menopausal symptoms in breast cancer survivors. *Oncology Nursing Forum*, 26(8), 1311–1317.
- Chedraui, P., Blumel, J. E., Baron, G. (2008) Impaired quality of life among middle aged women: a multicentre Latin American study. *Maturitas*, 61, 323–329.
- Chen, Y. L., Voda, A. M., Mansfield, PK. (1998) Chinese midlife women's perceptions and attitudes about menopause. *Menopause*, 5(1), 28–34.
- Cheng, M. H., Wang, S. J., Wang, P. H., Fuh, J. L. (2005) Attitudes toward menopause among middle-aged women: a community survey in an island of Taiwan. *Maturitas*, 52 (3-4), 348-355.
- Dennerstein, L., Dudley, E. C., Hopper, J. L. (2000) A prospective population-based study of menopausal symptoms. *ObstetGynecol*, 96, 351–358.
- Dennerstein, L., Dudley, E., Burger, H. (2001) Are changes in sexual functioning during midlife due to aging or menopause? *FertilSteril*, 76, 456–460.
- Dennerstein, L., Guthrie, J.R., Clark, M. (2004) A population-based study of depressed mood in middle-aged Australian-born women. *Menopause*, 11(5), 563–568.
- Dennerstein, L., Smith, A., Morse, C., Burger, H., Green, A., Hopper, J., Ryan, M. (1993) 'Menopausal symptoms in Australian women', Key Centre for Women's Health in Society, Carlton, Vic. *Medical Journal of Australia*, 159(4), 232–236.
- Dratva, J., Gomez, R. F., Schindler, C. (2009) Is age at menopause increasing across Europe? Results on age at menopause and determinants from two population-based studies. *Menopause*, 16, 385–94.

- Eisner, H., & Kelly, L., (1980) attitudes of women toward the menopause. Presented at the annual meetings of the American Gerontological Society. San Diego, CA.
- Freeman, E. W., Sherif, K. (2007) Prevalence of hot flushes and night sweats around the world: a systematic review. *Climacteric*, 10, 197–214.
- Genazzani, A. R., Nicolucci, A., Campagnoli, C. (2002) Validation of Italian version of the Women's Health Questionnaire: assessment of quality of life of women from the general population and those attending menopause centers. *Climacteric*, 5(1), 70-77.
- Genazzani, A. R., Schneider, H. P. G., Panay, N. (2006) The European Menopause Survey 2005: Women's perceptions on menopause and post menopause hormone therapy. *GynecolEndocrinol*, 22, 369–275.
- Gold, E. B., Sternfeld, B., Kelsey, J. L. (2000) Relation of demographic and lifestyle factors to symptoms in a multi-racial/ethnic population of women 40–55 years of age. *American Journal Epidemiology*, 152, 463–473.
- Gold, E. B., Bromberger, J., Crawford, S. (2001) Factors associated with age at natural menopause in a multiethnic sample of midlife women. *American Journal Epidemiology*, 153, 865–874.
- Gold, E. B., Colvin, A., Avis, (2006) Longitudinal analysis of the association between vasomotor symptoms and race/ethnicity across the menopausal transition: Study of Women's Health Across the Nation. *American Journal Public Health*, 96, 1226–1235.
- Gold, E. B., Block, G., Crawford, S. (2004) Lifestyle and demographic factors in relation to vasomotor symptoms: baseline results from the Study of Women's Health Across the Nation. *American Journal Epidemiology*, 159, 1189–1199.
- Gold EB, Crawford SL, Avis N, Crandall CJ, Matthews KA, Waetjen LE, Lee JS, Thurston R, Vuga M, Harlow S. (2013) Factors Related to Age at Natural Menopause: Longitudinal Analyses from SWAN. *American Journal of Epidemiology*; 178(1):70-83.
- Gupta, P., Sturdee, D.W., Hunter, M.S. (2006) Mid-age health in women from the Indian subcontinent (MAHWIS): general health and the experience of menopause in women. *Climacteric*, 9, 13–22
- Hilditch, J. R., Lewis, J., Peter, A., Van Maris, B., Ross, A., Franssen, E. (1996) A menopause- specific quality of life questionnaire: development and psychometric properties. *Maturitas*, 24(3), 161–175.
- Hunter M. (1992) The Woman's Health Questionnaire: A Measure of Mid-Aged Women's Perception of their Emotional and Physical Health. *Psychology and Health* 7:45-54.
- Hunter M & O'Dea I, (2001) Cognitive appraisal of the menopause: the menopause representation questionnaire. *Psychology Health and Medicine* 2:6: 65-76.
- Hunter, M. S. (2000) The Women's Health Questionnaire: the development, standardization and application of a measure of mid-aged women's emotional and physical health. *Quality of Life Research Journal*, 9, 733-738.
- Knobf, M. T. (2001) The menopausal symptom experience in young mid-life women with breast cancer. *Cancer Nursing Journal*, 24(3), 201–210.
- Lewis, J. E., Hilditch, J. R., Wong, C. J. (2005) Further psychometric property development of the Menopause-Specific Quality of Life questionnaire and development of a modified version, MENQOL-Intervention questionnaire. *Maturitas*, 50(3), 209–221.
- Meschia, M., Pansini, F., Modena, A. B. (2000) Determinants of age at menopause in Italy: results from a large cross-sectional study. ICARUS Study Group. *Maturitas*, 34, 119–125.
- McKinlay, S. M., Brambilla, D. J., Posner, J. G. (1992) The normal menopause transition. *Maturitas*, 14, 103-115.
- Melby, M. K. (2005) Vasomotor symptom prevalence and language of menopause in Japan. *Menopause*, 12, 250–257.
- MSD manual merk Ginecologia e Ostetricia 236. (2012) Menopausa. *Interruzione fisiologica delle mestruazioni dovuta a una ridotta funzione ovarica*. <http://www.msd-italia.it/altre/manuale/sez18/2362081.html>(parë për here të fundit më 20.02.2015).
- Obermeyer, C. M. (2000) Menopause across cultures: a review of the evidence. *Menopause*, 7(3), 184–192.
- Okeke, T. C., Anyaehie, U. B., Ezenyeaku, C. C. (2013) Premature menopause, *Annals of Medical and Health Sciences Research*, 3(1), 90–95.
- Randolph, J. F., Sowers, M., Bondarenko IV. (2004) Change in estradiol and follicle stimulating hormone across the early menopausal transition: effects of ethnicity and age. *Journal of Clinical Endocrinology and Metabolism*, 89, 1555–1561.
- Rebar R. W. (2000) Premature ovarian failure. In: Lobo, R. A., Kelsey, J., R. Marcus, R. *Menopause: Biology and Pathology*. New York: Academic Press.
- Remez, L. (2001) Multiple Factors, Including Genetic and Environmental Components, Influence when Menopause Begins Family Planning Perspectives, *Guttmacher Institute*, Vol. 33(5), 236.
- Report of a WHO Scientific Group. (1996) *Research on the Menopause in the 1990s, WHO technical report series 866*. Geneva: World Health Organization.
- Research Laboratories Merck, (2008) *The Merck Manual quintaedizione*, Milano: Springer-Verla
- Sherman, B. M., Korenman, S. G. (1975) Hormonal characteristics of the human menstrual cycles throughout reproductive life. *Journal of Clinical Investigation*, 55, 699–706.
- Schoenaker DA, Jackson CA, Rowlands JV, Mishra GD (2014). Socioeconomic position, lifestyle and age at natural menopause: a systematic review and meta-analyses of studies across six continents. *Int J Epidemiol* Oct;43(5): 1542-62.
- Slaven, L., Lee, C. (1997) Mood and symptom reporting among middle-aged women: the relationship between menopausal status, hormone replacement therapy, and exercise participation. *Journal of Health Psychology*, 16(3), 203-8.
- Speroff, L. (2002) The perimenopause. Definitions, demography, and physiology. *Obstetrics and Gynecology Clinics of North America*, 29, 397-400.
- Stewart, D.E. (2005) *Menopause A Mental Health Practitioner's Guide*, USA: American Psychiatric Publishing, Inc.
- Strauss, J. R. (2011) Contextual Influences on Women's Health Concerns and Attitudes toward Menopause. *Health & Social Work*, 36(2), 121-127.
- Tchen, N., Juffs, HG., Downie, FP., Yi Q-L, Hu H., Chemerynsky, I. (2003) Cognitive function, fatigue, and menopausal symptoms in women receiving adjuvant chemotherapy for breast cancer. *Journal of Clinical Oncology*, 21(22), 4175–4183.
- Utian, W. H. (2001) Semantics, menopause-related terminology, and the STRAW reproductive aging staging system. *Menopause*, 8, 398-401.
- Utian WH. The International Menopause Society, Menopause related terminology definitions. *Climacteric* 1999;2:284–6.
- Wiklund, I., Karlberg, J., Lindgren, R. (1993) A Swedish Version of the Women's Health Questionnaire, a Measure of Postmenopausal Complaints. *Acta Obstetrica Et Gynecologica Scandinavica*, 72, 1-8.
- Wilbur, J., Miller, A & Montgomery, A (1995) the influence of demographic characteristics menopausal status, and symptoms on woman's attitudes toward menopause. *Women and Health*. 23(3): 18-39.
- Wool, C., Cerutti, R., Marquis, P. (2000) Psychometric validation of two Italian quality of life questionnaires in menopausal women. *Maturitas*, 24(3), 161–175.

MOTIVACIONI DHE PRODUKTIVITETI I ORGANIZATËS

LULJETA BEXHETI

PhD Candidate, Universiteti Europian i Tiranës, Tiranë

Asistent/Ligjërues, Departamenti i Psikologjisë, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Maqedoni

ABSTRAKT

Ky studim ka për qëllim të sjell të dhëna mes lidhshmërisë së motivacionit dhe arritjes së produktivitetit në organizatë. Motivacioni është term shumë i zgjeruar, mirëpo, si indikatorë matës në këtë punim janë marrë vetëm nevoja për siguri, përkatësi dhe nevoja për vlerësim.

Duke filluar me një sfond teorik mbi rëndësinë e motivacionit në produktivitetin e organizatës, mund të potencojmë se një numër i madh i studimeve vënë në pah peshën e motivacionit që asocon si një segment që është bazë themelore, që duhet aprovuar, e cila paraqitet si një nga faktorët kryesor që luan rol në suksesshmërinë e ndonjë vendi punues, qoftë organizatë, kompani apo diçka tjetër. Menaxherët duhet të tregojnë interes mbi faktin se, cilët janë faktorët që rrisin motivacionin në punë që punonjësit e tyre të sillen në një mënyrë të tillë që organizata të merr përfitimin maksimal. Teknika kryesore që është përdorur për mbledhjen e këtyre informatave është pyetësori i përpiluar pikërisht për matjen e këtyre indikatorëve. Përpos pyetësorit, burim tjetër sa i përket të dhënave mbi produktivitetin në punë, janë marrë në raportet mujore mbi përfitimet e organizatave përkatëse, më pas është bërë krahasim mes qëndrimeve të subjekteve të fituara nga pohimet e pyetësorit që mat motivin e sigurisë, përkatësisë dhe motivin për vlerësim. Mostrën e përbëjnë vetëm të punësuarit në disa organizata private. Nga të dhënat e fituara, është konstatuar lidhshmëria e lartë pozitive që nënkupton se komponentët kryesorë në mes motivacionit dhe produktivitetit të organizatës kanë drejtim të njëjtë.

Fjalë kyç: *motivacioni, nevoja për siguri, përkatësi, vlerësim, produktiviteti*

Hyrje

Studimi në fjalë ka për detyrë të analizojë raportin ekzistues në mes motivacionit dhe rritjes së produktivitetit në punë. Shumë teori të ndryshme përpriqen të zbulojnë se nga motivohen njerëzit për të bërë punën e tyre dhe se si ky motivim ndikohet nga shpërblimi që ata marrin. Ekzistojnë kontestime të ndryshme të teorive që japin kuptim mbi motivacionin gjatë punës. Disa teori ekonomike¹ përqendrohen më tepër tek të ardhurat dhe shpenzimet, psikologët mbrojnë idenë se përfitimi është një motiv i konsiderueshëm në punën tonë, por jo determinues.² Kjo nënkupton faktin që ne shumë here motivohemi së brendshmi. Kanfer et al³, theksojnë mundësinë e përdorimit të burimeve për të realizuar sjelljen e dëshiruar. Ata vlerësojnë proceset motivuese si shumë të rëndësishme për individin dhe organizatën në tërësi.

Një punëtor i motivuar ndikon pozitivisht në arritjen e produktivitetit në organizatë. Për të pasur punëtor të motivuar duhet të ekzistojnë shumë faktorë të lidhura me kushtet e punës, strategjitë e organizatës, praktikat menaxhuese. Pavarësisht se shumë studime⁴ theksojnë faktin që politikat pozitive të motivimit të punëtorëve kanë ndikim në rritjen e produktivitetit, vlen për t'u përmendur roli i elementëve të jashtëm në këtë proces. Ndërhyrjet, shpërblimet apo stimujt tjerë të jashtëm rrisin motivet tona të brendshme për të bërë më mirë punën që na është ngarkuar.⁵ Në literaturën psikologjike kemi disa lloje që jepen mbi përkufizimin rreth motivimit duke u fokusuar së paku në dy aspekte themelore: së pari vetë termi motivim shënon përpjekjet dhe tentimet e individit drejt realizimit të nevojave jetësore⁶, së dyti termi merr një kuptim më specifik duke u ndërlidhë edhe me ndërhyrjet që bëhen nga jashtë për të përforcuar aspekte të veçanta.⁷

Sipas Maslow⁸, motivimi është një shtysë, dëshirë e organizmit për të përfunduar një punë e nisur më parë. Vroom⁹, motivimin e sheh të lidhur ngushtë me performancën duke potencuar faktin se sa më i lartë që është motivimi gjatë punës aq më shumë rritet performanca në punë. Teoria thekson se çdo person është vendimmarrës racional, i cili përcakton se cilat do jenë aktivitetet ku ai do të orientohet për të marrë shpërblimin e dëshiruar. Sa më e lartë të jetë pritshmëria e punëtorit, aq më shumë ai do të përpriqet dhe do kontribuojë me punën e tij.

Vite më vonë Golembiewski¹⁰, e përkufizoi motivimin si një gatishmëri të organizatës për të përmbushur qëllimet e vendosura duke shfrytëzuar më së miri burimet njerëzore. Këtu vihet në pah roli i drejtuesve, udhëheqësve, që të përdorin forma efektive motivuese. Së pari duhet realizuar nevojat personale dhe vlera e çdo punëtori. Nëse organizata harton planin me aktivitetet e punës për çdo punëtorë në mënyrë individuale, atëherë mund të konkludojmë se zgjedhja e duhur motivuese.

Në ditët e sotme psikologët janë mjaft të angazhuar në mirëmbajtjen homeostatike të organizatave, institucioneve, kompanive. Ata angazhohen dhe kontribuojnë që një organizatë të arrijë sukses dhe performancë. Ata kërkojnë se, cilat nga sjelljet dhe qëndrimet mund të përmirësohen, që nëpërmjet praktikës, programeve trajnuese të japin feedback pozitiv.

Dëgjohet nga çdo anë të flitet për kompanitë që bëjnë jehonë në avancimin dhe arritjet e mëdha përparuese. Po ashtu ndodh të dëgjojmë se si një ndërmarrje e madhe kapitullon nga mosrealizimi i disa hapave që mirëmbajnë dhe udhëheqin në kahun të duhur suksesin e saj. Shumëkush mund të parashatrojë pyetje, se si ka mundësi disa nga vendet e punës të shfaqin sukses dhe të ruajnë strukturën menaxhuese me shumë vitalitet, dhe si nga ana tjetër shohim një ulje dhe një menaxhim jo të efektshëm, që rezulton me humbjen e produktivitetit në punë?! E gjithë kjo asocohet me përkushtimin e një segmenti që është bazë themelore, që duhet aprovuar, siç është motivacioni, e cila paraqet një nga faktorët kryesor që luajnë rol në suksesshmërinë e ndonjë vendi punues, qoftë organizatë, kompani apo diçka tjetër.

Psikologjia industriale është fusha ideale, që na mëson se si duhet menaxhuar një vend pune. Kontekstet e organizuara brenda punës prekin shumë pikëpamje apo funksione si, lidhshipin (sa lidhshipi i influencën punëtorët), interaksionin mes grupeve apo ekupeve punuese, tema të ndryshme siç janë: motivacioni i punës, emocionet, kënaqësia në punë. Të gjithë këto konsiderohen si aspekte të psikologjisë së punës.

Psikologjia organizative ka qasje mbi resurset humane, ajo bënë kërkime që të shprijnë në zhvillimin e veglave për resurseve njerëzore, për shembull, ata e performojnë sistemin menaxhues, apo zhvillojnë programin e lidhshipit, në atë kah që të sjell resurse për punëtorët. Psikologjia organizative apo e punës, mundohet të siguroj instrumente për organizatën, për të tërhequr, selektuar, trajnuar dhe ndihmuar organizatën për ngritjen e performancës në mjedisin e punës. Shumë vende pune preferojnë të punësojnë ata kandidatë që janë më të kualifikuar, të cilët kanë njohuri më të pasur dhe janë mjaft të shkathët në kryerjen e punëve të ndryshme.

Esenca e menaxherit është analiza e punës, procesi sistematik i të kuptuarit dhe të njohurit e aftësive, shkathhtësive si dhe shumë karakteristikave të tjera individuale, që janë të nevojshme për performancën në punë. Qëllimi i menaxherit është se si ta bëjë organizatën më produktive, si dhe të siguroj mbështetje fizike dhe psikologjike për punëtorët.

¹ Theory of homo economicus. Retrieved from: http://en.wikipedia.org/wiki/Homo_economicus

² Frey, B. S, Benz, M. (2002), *From Imperialism to Inspiration: A Survey of Economics and Psychology*, Zurich: Institute for Empirical Research in Economics, Working Paper No. 118, fq 3 – 4

³ Kanfer R, Chen G & Pritchard. R, (2008) *Work motivation. Past, present and future*. Routledge, Taylor & Francis Group, London. Fq

⁴ 3-5. McClelland, D.C (1985). *How motives, skills and values determine what people do*. American Psychologist, 40, 812-825

⁵ Plantinga M, 2006, *Employee Motivation and Employee Performance in Child Care. The effects of the introduction of market forces on employees in the Dutch child-care sector*. ISBN 90-367-2695-6, fq 3

⁶ Maslow, A.H. (1943). *A theory of Human Motivation*. Psychological Review. f.370

⁷ Maslow. Po aty. f.375

⁸ Maslow. Po aty. f.250

⁹ Vroom V H. 1964. *Work and motivation*. New York: Wiley. f 331.

¹⁰ Golembiewski, R. T. (1973). *Motivation*. In Carl Heyel (Ed.), *The Encyclopedia of Management 2nd*. New York: Van Nostrand Reinhold

Një udhëheqës efikas sipas studimit të realizuar nga Blum dhe Nazler (1968), i cili studim definohet si “Studim shkencorë mes udhëheqësit dhe botës në punë”, aftësitë udhëheqëse kanë rol ndikues në: “aplikimin gjithëpërfshirës të ngjarjeve dhe principeve që kanë të bëjnë me qenien njerëzore në kontekstin e biznesit dhe industrisë”.

Motivet personale

Motivet personale mund të jenë çelësi i karrierës së suksesshme. Këto motivacione shpesh kundërshtojnë tipare të tjera, e tejkalojnë situatën duke e aktivizuar procesin mendor në mënyrë racionale. Ekzistojnë disa lloje të motivacionit personal, ato janë:

- Përshtatja e pasionit me misionin- Entuziazmi mund të jetë një motiv personal i fuqishëm, sepse ruan energjinë e njeriut. Pasioni dhe dëshira që ndjejmë për ndonjë objekt dhe përpjekja e vazhdueshme e jona mundëson arritjen e saj. Nëse nuk jeni të gatshëm të bëni punën që doni, gjeni mënyra që inkorporojnë ata aspekte që ju i dëshironi në jetën tuaj të përditshme.
- Përmirësimi i shkathtësive- Organizoni detyra ditore, duke i shkruar në një listë, dhe për çdo ditë ushtroni shkathtësitë e nevojshme. E gjithë kjo praktikë, do të sjell në drejtim të zmadhimit të efektit në punë.
- Mbaj krenari në punë- Drejto çdo projekt që kanë përmbytje të nivelit të lartë, dhe do ndjeheni të integruar, entuziazmuar dhe të profesionalizuar. Nga ana e kolegëve ju do shikoheni me një mendim pozitiv, si dhe superioriteti juaj do të respektohet.
- Largohuni nga eksperiencat negative- Situatat pesimiste, zënkat e ndryshme, mund të të sjellin në një dështim të panevojshëm që shkakton humbjen e ndjenjës profesionale dhe produktivitetit në punë.
- Bëje një ndërprerje- Shko në drekë me një shokë të mirë, dhe nëse është një ditë e mirë, bëje një shëtitje. Këto ide shërbejnë si relaksim i trurit të lodhur. Përkujto! Sikur të zbrazet bateria e celularit, dhe ne menjëherë vrapojmë për ta rimbushur atë, e njëjta gjë vlen edhe për relaksim trunor.
- Mbështetu tek tjetri- Nëse ndesheni me ndonjë problem rreth projektit, kërko ndihmë nga të tjerët.
- Kuptoje vetveten- Nëse ndodh të gaboni, mos lejoni që ky gabim t’ju mposht. Mëso nga gabimi dhe identifikoj mënyrën se si duhet të veprësh herën tjetër.

Motivacioni në punë

Motivacioni në punë është një ndër çështjet kyçe që trajton psikologjia e punës. Teoritë organizative si studime interdisiplinor shqyrtojnë strukturën, funksionin e organizatës si dhe sjelljen e njerëzve brenda organizatës. Duke u nisur nga fakti se qenia njerëzore ka nevoja të ndryshme në bazë të cilave edhe i përcakton qëllimet që ka për synim t’i ndërmerret, kjo nënkupton se procesi i motivimit është shumë i sofistikuar dhe kërkon trajtim të posaçëm. Për këtë arsye vetëm një teori nuk mund t’i kënaq të gjithë nevojat e duhura.

Teoritë e motivimit përpiqen të analizojnë dhe shpjegojnë, përse njerëzit në punë priren të reagojnë në përputhje me përpjekjet dhe kontributin personal. Ato përshkruajnë format dhe mënyrat efikase sesi organizata mund t’i stimulojë punonjësit drejt arritjes së rezultatit, pse jo duke përmbytur edhe nevojat personale të gjithsecilit.¹¹ Teoritë e para mbi motivimin njihen dhe janë, teoria e motivimit për arritje e Atkinsonit dhe hierarkia e Masllovit.

Teoria e motivimit në punë sipas Masllow

Teoria e Masllovit mbi hierarkinë e nevojave, vendos në konsideratë motivacionin si një nga elementet kryesore të zhvillimit individual. Duke u bazuar në këtë teori, mund të potencojmë se njerëzit nëse nuk i kanë të plotësuar nevojat e tyre në punë, nuk mund të realizon plotësisht potencialin e tyre. Nevojat sipas Masllow, kanë një radhitjeje mes tyre duke nisur nga ato primaret dhe të domosdoshmet:¹²

Motivet biologjike, përfshinë nevojat bazë të jetës p.sh motivi i etjes, urisë, nevojat seksuale, nevoja për strehim etj. Motivi i sigurisë, fillon të bëhet dominues pasi të jenë realizuar nevojat biologjike. Njerëzit mundohen të jenë të sigurt nga rreziqet fizike, nga frika e humbjes së vendit të punës, të kenë të ardhura mujore të sigurta për të mbijetuar.

Motivi për përkatësi dhe dashuri, përfshinë nevojën për t’u rrethuar nga persona të dashur e për të qenë pjesë e dikujt. Menaxherët mund të luajnë rol të rëndësishëm duke i inkurajuar njerëzit që të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, punëtori të përfiton ndjenjën se respektohet si njeri dhe plotësimi i shumë nevojave tjera sociale.¹³

Motivi për vlerësim, manifestohet me dëshirën për tu treguar të aftë, të lirë, të njohur dhe të fuqishëm. Faktorë të jashtëm të këtij motivimi janë: lëvdatat, mirënjohja, statuti, shpërblimet mbi suksesin e treguar etj.

Armstrong M, (2006), *A handbook of human resource management practice*, 10 edition, London, Kogan Page, fq 251 – 253

Spahiu, B. (1999). *Psikologjia*. Libri Shkollor. Prishtinë. f.191

Appley M. H & Cofer C. N (1964). *Motivation: Theory and Research*, New York Wiley, fq.684 dhe fq.691

Motivi i vetaktualizimit, ka të bëjë me realizimin e potencialit të veçantë. Nxitja e individit për t'u bërë ai që është, nevoja për t'u rritur, për të përparuar e për të qenë krijues në shoqëri. Me një fjalë, nevoja për t'u vetërealizuar.

Teoria motivim-higjienë nga Herzberg et al

Teoria e motivim-higjienë nga Herzberg¹⁴ mbetet një nga bazat kryesore ku është mbështetur modeli i karakteristikave të punës. Çështja kryesore që përmendet në këtë teori është fakti se, cilat janë ato elemente që e bëjnë punëtorin të jetë i kënaqur ose i pakënaqur gjatë punës. Punëtorët që tregohen se janë të kënaqur, këtë kënaqësi ia atribuojnë faktorëve subjektiv, kurse ato që ndjehen të pakënaqur këtë pakënaqësi ua atribuojnë faktorëve të jashtëm.¹⁵

Teoria e Herzberg e vë theksin fillimisht në elementët e brendshëm që ndikojnë në motivimin e punëtorëve si arritja, sukcesi, përgjegjësia, mirënjohja, rritja profesionale, kompetenca. Këto variabël janë klasifikuar në grupin e faktorëve motivues pasi nxisin punëtorët të japin maksimumin në atë që e bëjnë. Në anën tjetër të medaljes teoria pozicionon faktorët tjerë (higjiene) të njohur ndryshe si motivacion i jashtëm. Këtu citojmë marrëdhëniet me kolegët dhe eprorin, kushtet në punë, përfitimet, politikat e kompanisë etj.¹⁶

Herzberg i pa faktorët të ndarë në dy dimensione, secili ndikon kënaqësinë nga puna në forma të ndryshme. Prandaj përmirësimi i një faktori të jashtëm nuk do t'i bëjë njerëzit të kënaqur me nevojat e tyre, por vetëm do të parandalojë që ata të jenë të pakënaqur. Sipas tij, faktorët e jashtëm janë parandalues të pakënaqësisë, por kjo nuk nënkupton se ato sjellin domosdoshmërisht kënaqësi. Ato shërbejnë vetëm për të shmangur ndjenjat negative në punë. Faktorët motivues janë të vetmit që shërbejnë për të nxitur dhe motivuar punëtorët. Nëse udhëheqësit duan të rrisin motivacionin e punëtorëve, mund të ndërhyjnë përmes ristrukturimit të punës. Nëse punëtorët janë të motivuar së brendshmi dhe së jashtëmi, rezultati është më i arritshëm. Ndërkohë gjatë zhvillimit të psikologjisë organizative, teoritë e strukturimit të punës u fokusuan në gjetjen e ekuilibrave mes individit dhe punës që ai bën. Në vijim janë disa aspekte të diskutuara, apo disa teori që flasin mbi motivacionin në punë:

McGregor's Theory X dhe Theory Y Duaglas McGregor (1960), kanë përmbledhur dy forma menaxhuese, që janë praktikuar më herët.

Teoria X është teori tradicionale, sipas të cilës punëtorët nuk e admirojnë vendin e punës dhe përipiqen t'i shmangen punës. Sipas funksionimit menaxhues, te punëtorët duhet me forcë të ndikojmë që ata të punojnë, duhet t'ju kanosemi duke i ndëshkuar. Gjithçka për ato që është e motivuar, janë paratë.

Teoria Y është teori më humane, vetaktualizim drejt motiveve të tyre. Nganjëherë thirret edhe si model i resurseve humane, ata kanë qëndrimin se puna është diçka natyrale, e cila sjell satisfakcion. Punonjësit më tepër duan të jenë përgjegjës dhe të involvohen në menaxhim për shkak të arritjes së motivacionit. Menaxhuesi merr parasysh edhe participimin e punëtorëve në lidhje me ndonjë vendim që ndërmerret. Peters dhe Waterman (1982) në librin e tyre, "Në kërkime ekselente", kanë përpunuar dallimin mes menaxhimit në Amerikë dhe në Japoni, dhe kanë ardhur në përfundim se menaxherit amerikan përdorin Teorinë X, kurse menaxhuesit japonez tentojnë të përdorin Teorinë Y.

Teoria Z, është teori e krijuar nga William Ouchi (1981), i cili në librin e tij, "Teoria Z", përshkruan karakteristikat e kompanive japoneze, që përmbajnë një numër të madh të punëtorëve, të cilët janë mjaft besnik, të motivuar dhe produktiv. Shumë punëtor ja japonez punën e tyre e kanë të garantuar me pozitë të përyetshme. Kompanitë në Japoni shpesh janë të koncentruar rreth gjithë aspekteve të jetës ndaj punëtorëve të tyre. Sipas Ouchi, Teoria Z tenton që të ketë ekuilibër punuese stabile, produktivitet të lartë, si dhe satisfakcion dhe mbështetje të plotë ndaj punëtorëve.

Psikologjia e punës ka si interes sjelljen e strategjive t'ju ndihmojë punëtorëve në zmadhimin e kualiteteve gjatë punës, duke përfshirë përmirësimin dhe sigurimin e kushteve, rritjen e përgjegjësisë në punë dhe sjelljen e stabilitetit financiar.

Përse mësohet dhe zbatohet parimi i motivacionit në punë?

Detyra e menaxherit në vendin e punës është që të rrisë motivacionin. Kjo është e lehtë që të thuhet, se sa të bëhet! Në disa kërkime flitet se motivacioni nuk është mjaft mirë i kuptuar dhe shumë shpesh "i varfër në praktikë". Për të kuptuar motivacionin, së pari duhet kuptuar natyra e qenies njerëzore, dhe këtu pikërisht qëndron problemi! Natyra humane mund të duket shumë e thjeshtë dhe njëkohësisht shumë komplekse. Të kuptuarit e natyrës humane ndikon domosdoshmërisht në të kuptuarit e motivacionit. Pjesa e tërësishme e vlerës morale është të trajtohen njerëzit në mënyrë të barabartë, disa observime tregojnë që një numër i punëtorëve të respektuar dhe të motivuar japin produktivitet dhe kreativitet më të lartë. Ekziston një thënie e hershme se: mund të dërgojmë kalin deri te uji, por ne nuk mund me forcë ta detyrojmë të pije ujë, ai do të pije vetëm atëherë kur do të jetë i etshëm. Po ashtu edhe me njerëzit, ata do ta bëjnë atë që dëshirojnë ta bëjnë ose atë që janë të motivuar ta bëjnë, dhe jo ne të ndikojmë në mënyrë të detyrueshme mbi ta.

Performanca konsiderohet dhe përfitohet nëse në mes veti funksionojnë aftësitë dhe motivet.

$$\text{Performanca} = f(\text{aftësive}) + (\text{motivacionit})$$

Aftësitë e një menaxheri varen nga eksperiencia, trajnimet që përmirësohen dhe përforcohen gjatë përvojës. Nga ana tjetër motivacioni mund të përmirësohet shumë shpejtë, nëse një udhëheqës i ka këto aftësi të përfituara nga eksperiencia. Në rastë

Frederick Herzberg's motivation and hygiene factors. Retrieved from: <http://www.businessballs.com/herzberg.htm>

Frederick Herzberg's motivation and hygiene factors. Po aty. Retrieved from: <http://www.businessballs.com/herzberg.htm>

Hong T.T & Aheed A. (2011). *Herzberg's motivation-hygiene theory and job satisfaction in the retail sector: the mediating effect of love of money*. Asian Academy of Management Journal. Vol.16, No.1, 73-94, Malaysia.

se një udhëheqës, nuk e ka të qartë se nga t'ia filloj punës së tij për ngritjen e motivacionit të punëtorëve, më poshtë janë disa strategji, apo instrumente që udhëzojnë mënyrën se si duhet të veprojë:

- T'i trajtojë në mënyrë të barabartë.
- T'ua plotësojë nevojat e tyre.
- Të përdor shpërblime në punët që tregojnë performancë.
- Të mbajë disiplinë efektive.
- Të drejtoj punën drejt qëllimit.
- Të fitoj besimin, respektin dhe bindjen tek punëtorët.
- Nganjëherë të zbutë sistemin, metodën e të të punuarit.
- Të ketë komunikim të mirë me ata.

Qëllimi i studimit

Qëllimi i këtij studimi është përcaktimi i raporteve mes motivacionit në punë dhe arritjes së produktivitetit në radhën e punëtorëve të angazhuar nëpër organizata private. Gjegjësisht, punimi në fjalë tenton të gjejë marrëdhënien që ekziston ndërmjet motivimit dhe faktorëve që ndikojnë në të, nevojave për siguri, shoqëri dhe vlerësim dhe ndikimi i tyre në produktivitetin e punës.

Pyetja kërkimore, hipotezat dhe metodologjia e punimit

Cila është marrëdhënia mes motivacionit të punëtorëve dhe produktivitetit të lartë në punë?

Hipoteza bazë e këtij hulumtimi është Ekziston lidhshmëri e ngushtë mes motivacionit dhe produktivitetit të lartë në punë.

Operacionalizimi i variabileve

Operacionalizimi i variabileve është bërë duke u mbështetur në teorinë kryesore mbi motivacionin, konkretisht për bazë kemi pasur hierarkinë e Masllovit, duke u fokusuar në nevojat apo motivin për siguri, shoqëri dhe vlerësim. Këto indikatorë i kemi zbërthyer në komponentë më të imëta edhe atë: pagesa apo rroga, kushtet e punës, marrëdhëniet ndërpersonale, marrëdhënia me udhëheqësin.

Në lidhje me pagesën apo rrogën kemi nënkuptuar faktin se ajo përbën hapin e parë që i jep nxitje organizmit; kushtet e punës përfshijnë ambientin brenda punës, mjetet, pajisjet, temperatura, komoditeti; Marrëdhëniet ndërpersonale vendojnë në pah kontaktin dhe raportet kolegjiale brenda orarit të punës; Kurse marrëdhënia me udhëheqësin nënkupton shkallën e vlerësimit në ekzistimin e raportit me udhëheqësin, ndikimi i lëvdatave, respektit, mirënjohjeve etj. Duke i zbërthyer në elemente më të imëta këto indikator, përfitojmë njëkohësisht informata se sa këto elemente ndikojnë në rritjen e produktivitetit në organizatë.

Mostra e subjekteve

Motivacioni në punë si faktor i rëndësishëm i sjelljes së produktivitetit të lartë në punë, është hulumtuar me një mostër, ku janë përfshi 60 persona, të punësuar në dy organizata apo ndërmarrje tregtare. Të anketuarit i kanë takuar popullatën nga qyteti dhe rajoni i Tetovës, të gjithë me përvojë pune mbi 2 vjet. Plotësimi i pyetësorit është realizuar në varësi të gatishmërisë dhe dëshirës së punëtorëve për t'u përfshirë në këtë studim.

Teknikat përdorëse


Në këtë studim është përdorur pyetësori që synon të mbledh informacione mbi nevojat që kanë ndikim në motivimin e punëtorëve gjatë punës së tyre. Për këtë është shfrytëzuar "shkalla e nevojave në punë" nga Brady, që mat nevojat që ndikojnë në nxitjen dhe motivimin e punëtorëve. Duke qenë në përputhshmëri edhe me motivet apo nevojat e teorive të Maslow dhe Herzberg të cituara si më të rëndësishme, pyetësori bën matjen e sigurimit të kushteve në punë, nevojën për të qenë pjesë e shoqërisë, grupit, nevojën për t'u mirëpritur dhe vlerësuar brenda grupit dhe mbështetja e vazhdueshme e udhëheqësit. Shkallët e vlerësimit të janë realizuar me anë të shkallës së Likertit.

Pyetësi përbëhet nga 16 pohime, duke paraqitur më pas pohime që masin nevojat mbi motivin e sigurisë (pohimi 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7), motivin e përkatësisë në shoqëri (8, 11, 12, 15, 16) dhe motivin e vetëvlerësimit (9, 10, 13, 14).

Analizë dhe interpretim të dhënash


Për përpunimin e të të dhënave janë analizuar veçmas të gjitha pyetjet e pyetësorit, dhe rezultatet e tyre janë paraqitur në formë grafike të shtyllave. Grafikoni i shtyllave i paraqitur në vijim, jep pamjen e përgjigjeve mbi nevojat apo motivet e studiuara në këtë punim, duke e vlerësuar shkallën e qëndrimit të tyre në pesë kategoritë e Likertit.

GRAFIKU 1. PARAQITJA GRAFIKE MBI NEVOJAT QË KANË LIDHSHMËRI ME PRODUKTIVITETIN NË PUNË



Grafikoni i shtyllave tregon dukshëm se një numër i konsideruar i participuesve në tre nevojat matëse të motivimit të tyre, nevoja për siguri, nevoja për shoqëri dhe nevoja për vlerësim, të cilat nevoja ndikojnë në rritjen e performacës së organizatës ku ato janë të angazhuar janë shprehur me shkallën e vlerësimit 5, që ka kuptimin se plotësisht pajtohem. Kjo na lë të kuptojmë se numri më i madh i punëtorëve janë të motivuar dhe i kanë të plotësuara tre motivet e parashtruara që nënkupton se ato janë të prirur të punojnë drejt rritjes së profitabilitetit të organizatës.

GRAFIKONI 2. PARAQITJA E REZULTATEVE PËR NEVOJËN E SIGURISË




Sa i përket të dhënave të fituara nga grafikoni 2. që paraqesin qëndrimet e të punësuarve mbi nevojën për siguri në kompanitë pjesëmarrëse në hulumtim, të cilat qëndrime janë vlerësuar me pesë kategoritë e Likertit, shohim se në të shtatë pyetjet matëse të kushteve fizike apo nevojës për siguri, dominojnë qëndrimet e kategorisë së pestë, që ka kuptimin plotësisht pajtohem.

Në pohimin e parë “ Më pëlqen punën që e ushtroj”, shohim se nga numri i përgjithshëm (n=60), gjysma e tyre janë shprehur se plotësisht e pëlqejnë punën e tyre, mbi 15 të punësuar janë shprehur se pajtohen me punën që e ushtrojnë dhe një numër diku rreth 12 persona konsiderojnë se kanë qëndrim neutral sa i përket punës që ata e punojnë.

Gjithashtu në pohimin e dytë “Pagesën që e marr është në të njëjtin nivel me ato të organizatave tjera të ngjashme me ne”, pohimin e katërt “Kjo ndërmarrje është korrekte në dhënien e rrogës në kohë të caktuar” dhe në pohimin e gjashtë “Kemi vegla dhe materiale të nevojshme për punën që duhet të realizojmë”, vërejmë se kemi opinione me, plotësisht pajtohem, mbi 40 të punësuarve që është vlerë për t’u konsideruar.


GRAFIKONI 3. PARAQITJA E REZULTATEVE MBI NEVOJËN PËR SHOQËRI



Në lidhje me të dhënat e fituara nga grafikoni 3. që na japën qëndrimet e të të pyeturve në lidhje me plotësimin e nevojave shoqërore dhe motivacionit të tyre për të ngritur performancën e punës, shohim se, një numër i madh i tyre kanë potencuar se nëse ato i kanë të plotësuar motivet shoqërore, kjo do ju shërbej si nxitës që ato të angazhohen që kompania përkatëse të ketë më shumë produktivitet.

Në grafikonin mbi pohimin e 12 “Sjellja ndaj të punësuarve është shumë korrekte” shohim se kemi nivel më të ulët të shtyllës me ngjyrë të kaltërt dhe se dominon shtylla me ngjyrë vjollce, por që sërish ka kuptimin e një lloj pajtueshmërie. Në përgjithësi të fituarat mbi motivet apo nevojat shoqërore, posaçërisht, pohimi 16 “Ndjem i motivuar në punë kur vlerësohem nga kolegët tjerë” dhe pohimi 15 “Kemi raporte të mira mes kolegëve”, na japin të dhëna që tregojnë se më shumë se gjysma e të punësuarve janë plotësisht të kënaqur mbi marrëdhëniet ndërpersonale në punën e tyre dhe një pjesë e vogël shprehin pakënaqësi në këtë drejtim. Këto të dhëna ngrinin vlerën e relacionit në mes plotësimit të këtij motivi dhe rritjes së produktivitetit në punë.

GRAFIKONI 4. PARAQITJA E REZULTATEVE MBI NEVOJËN PËR VLERËSIM



Përgjigjet e marrura sa i përket grafikoni 4, prezantojnë qëndrimet e punëtorëve në lidhje me indikatorin e tretë të motivacionit, nevojës për vlerësim, si faktor i rëndësishëm dhe me ndërlidhje të ngushtë në ngritjen e performancës dhe produktivitetit të organizatës.

Të pyeturit me pohimin e nëntë, se a vlerësohen nga udhëheqësit, shohim se shumica e të punësuarve janë shprehur se ndjehen të vlerësuar dhe të respektuar në këtë raport, dhe dhjetë prej tyre kanë qëndrim neutral. Rezultatet e treguar në shtyllën e dytë të pohimit dhjetë, mbi qëndrimin se, a vazhdojnë të punojnë punëtorët për të ngritur produktivitetin e organizatës edhe nëse udhëheqësi nuk preokupohet për nevojat e tyre, duke i krahasuar me të dhënat e shtyllave tjera, shohim se pjesa më e madhe e të pyeturve kanë dhënë qëndrimin se aspak nuk pajtohen ose nuk pajtohen në angazhimin e tyre për dobinë e organizatës nëse udhëhiqen nga një mbikëqyrës që nuk tenton në realizimin e nevojave të tyre. Nga ana tjetër të dhënat e përfituara nga pohimi katërmëdhjetë, ku numri më i madh kanë pohuar se, punëtorët konsiderojnë se e kanë përkrahjen e udhëheqësve të tyre dhe se ky raport rrit satisfaksionin dhe motivimin e tyre për të punuar më shumë. Këto informata na lejojnë në konstatimin se punëtorët dëshirojnë të jenë të motivuar që të kenë zotim më të lartë organizativ.

Konkluzion

Të arriturat e të dhënave nga grafikoni 2, për indikatorin e parë që përfshinë realizimin e nevojave fizike ose motivit të sigurisë, duket qartë se punëtorët e shohin si pjesë shumë të rëndësishme plotësimin e nevojave të sigurisë, mjetet dhe pajisjet, rrogën dhe kushtet fizike dhe tregojnë një kënaqësi të lartë në relacion me organizatën sa i përket këtyre pikëpamjeve. Numri më i madh i punëtorëve mendojnë se paguhen aq sa duhet për kontributin që japin dhe punën që bëjnë dhe se pagën mujore e marrën në kohë të caktuar. Në lidhje me pajisjet, veglat dhe kushteve tjera gjithashtu shohim se numri më i madh i punëtorëve janë shprehur të dakorduar se janë në dakord me këto nevoja dhe një pjesë shumë e vogël nuk kanë qenë të kënaqur në lidhje me këto faktorë.

Rezultatet e fituara në grafikoni 3, kanë të bëjnë në lidhje me dimensionin e dytë të marrë në shqyrtim, nevojën për shoqëri, një ndër faktorët që shpije organizatën në rritje të fitimit. Faktorët matës sa i përket kësaj nevoje kanë qenë komoditeti në punë, marrëdhëniet kolegjiale, emërimet për punëtorin më të mirë gjatë muajit. Shtyllat e grafikoni na jepet të dhëna se në të gjitha pohimet matëse nga numri i përgjithshëm (n=60) mbi 30 subjekte kanë treguar pajtueshmëri të plotë sa i përket këtyre faktorëve dhe një pjesë shumë e vogël prej tyre shprehin pakënaqësi në këtë drejtim. Kjo tregon se ata ndjehen mirë me kolegët në punë, ka atmosferë mirëbesimi, fjalët e mira, nxjerrja e punëtorit më të mirë gjatë muajit i nxit që ata të përpiqen për të dhënë maksimumin në atë që bëjnë.

Dimensioni i fundit i analizuar në këtë punim është motivi për vlerësim si indikator i rëndësishëm që duhet realizuar me qëllim që të kemi produktivitet në organizatë. Grafikoni 4 paraqet të dhënat e përfituara në lidhje me faktorët matës të këtij motivi. Për të pasur si qëllim përfitimin e organizatës, shtresa udhëheqëse duhet të dijë mirë të manipulon dhe të ketë në konsideratë mënyrën e vlerësimit ndaj punëtorëve. Rezultatet tregojnë se punëtorët ndjehen të vlerësuar nga udhëheqësit e tyre dhe një numër diku rreth 10 subjekte kanë shprehur qëndrim lëkundës në lidhje me këtë raport. Më shumë se 30 subjekte janë shprehur se aspak nuk do tentojnë të vazhdojnë të punojnë për organizatën nëse kanë një udhëheqës që nuk preokupohet për nevojat e tyre dhe mbi 10 subjekte kanë qenë indiferentë sa i përket këtij qëndrimi. Këto të dhëna na jepen mundësinë të konkludojmë se sa është e rëndësishme që udhëheqësi të plotësojë motivet apo nevojat e punëtorëve, të bëjë vlerësim të drejtë dhe të krijoj raport të shëndosh mes tyre nëse ka për synim zotimin e tyre ndaj organizatës. Shtyllat e fundit të grafikoni 4. japin të dhëna të rëndësishme sa i përket qëndrimin të punëtorëve ku mbi 30 subjekte kanë potencuar se kanë përkrahjen nga mbikëqyrësit dhe kjo mbështetje ndikon që ato të motivohen më shumë për të punuar. Në bazë të rezultateve të përfituara të cilat flasin për një përputhje pothuajse të tërësishme mbi plotësimin e nevojave apo motiveve dhe ngritjes së produktivitetit të organizatës, gjithashtu duke u bazuar në të dhënat e vëzhguara gjatë tre muajve të raporteve mujore apo përfitimeve të kompanive që kanë korresponduar me ngritje të produktivitetit në krahasim me muajt apo vitet e kaluara, mund të konkludojmë se pohimi apo hipoteza jonë pranohet. Rezultatet e fituara në këtë punim konfirmojnë mendimin e shumë hulumtuesve, se po të rritet motivacioni i punëtorëve, atëherë gjasat janë të mëdha për arritje të produktivitetit të lartë. Këto gjetje theksojnë faktin se punëtorët motivohen në punën e tyre, kur kanë kushte të favorshme, kanë marrëdhënie të mirë kolegjiale, shpërblehen dhe vlerësohen për atë që bëjnë.

Bibliografia

- Appley M. H & Cofer C. N (1964). *Motivation: Theory and Research*, New York Wiley, fq.684 dhe fq.691
- Argyl,M. Henderson,M. (1984). *The Rules of Friendship*, Journal of Social and Personal Relationships, Vol. 1, No. 2.
- Armstrong M, (2006). *A handbook of human resource management practice*, 10 edition, London, Kogan Page, fq 251 – 253
- Cascio, W.F. (1995). *Managing Human Resources, Productivity, Quality of Work Life, Profits*. McGraw-Hill Companies. New York.
- Daft, R.L.(2002). *The leadership Experience*. Thomson Learning South Western. Mason. Ohio.
- Frey, B. S, Benz, M. (2002), *From Imperialism to Inspiration: A Survey of Economics and Psychology*, Zurich: Institute for Empirical Research in Economics, Working Paper No. 118, fq 3 – 4
- Golembiewski, R. T. (1973). *Motivation*. In Carl Heyel (Ed.), *The Encyclopedia of Management 2nd*. New York: Van Nostrand Reinhold
- Hellriegel, Don & Slocum,W.John. (2007). *Organizational Behavior*. Thomson Higher Education. USA.
- Hong T. T & Aheed A, 2011. *Herzberg's motivation-hygiene theory and job satisfaction in the retail sector: the mediating effect of love of money*, Asian Academy of Management Journal, Vol. 16, No. 1, 73–94, Malaysia.
- Humphery, R. (1985). *How work roles influence perception: Structural cognitive processes and organizational behavior*. American Sociological Review.

- Kanfer R, Chen G & Pritchard. R, (2008) *Work motivation. Past, present and future*. Routledge, Taylor & Francis Group, London. fq 3-5.
- Maslow, A.H. (1943). *A theory of Human Motivation*. Psychological Review.
- McClelland, D.C (1985). *How motives, skills and values determine what people do*. American Psychologis, 40, 812-825
- Plantinga M, 2006, *Employee Motivation and Employee Performance in Child Care. The effects of the introduction of market forces on employees in the Dutch child-care sector*. ISBN 90-367-2695-6, fq 3
- Spahiu, B. (1999). *Psikologjia*. Libri Shkollor. Prishtinë. f.191
- Vroom V H. 1964.*Work and motivation*. New York: Wiley. f 331.

NDIKIMI I STILIT TË JETËS TE PACIENTËT ME HIPERTENSION ARTERIAL NË RAJONIN E PRIZRENIT

NDERIM RIZANAJ

Doktorant, Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti i Psikologjisë, Profili Psikologji shëndeti

ABSTRAKT

Hipertension shfaqet atëherë kur furnizimi me gjak nëpërmjet enëve të gjakut e kalon masën, duke ushtruar tryzni mbi muret e enëve të gjakut. Kur presioni i lartë i gjakut ndodhë në mënyrë kronike, ai mund të shkaktojë një fortësim të mureve të arterieve dhe prishjen e sipërfaqes së qelizave. Janë rreth 60 milion njerëz që vuajnë nga hipertension në SHBA ndërsa në Kosovë 77% e popullatës, kjo sëmundje paraqet 57% të shkaqeve të vdekjes në Kosovë.

Qëllimi: Të kuptojmë ndikimin e stilit të jetës te pacientët me hipertension arterial në rajonin e Prizrenit. Metodologjia: Në këtë hulumtim janë përfshirë 233 pacientë me hipertension arterial. Mbledhja e të dhënave është bërë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prizren dhe në Ambulancën Private "Nderimet" në Zhur. Përzgjedhja e pacientëve është bërë në mënyrë të randomizuar nga të cilët është kërkuar të plotësohet pyetësori i strukturuar dhe përkthyer në gjuhën shqipe (Life Style Questionnaire and Perceived Stress Scale).

Rezultatet: Sa i përket përfaqësimit të gjinisë 109 (47%) ishin meshkuj ndërsa 124 (53%) ishin femra. Grup moshë më e prekur ishte ajo mbi 65 vjeç (45.5%) pastaj grup moshë 55-64 ku ishin 72 (30.9%) pacientë. Shumica e pjesëmarrësve 158 (67,8%) ishin me shkollim fillor. Ushtrime fizike bënë vetëm 33 (14.2%) ndërsa nuk bënë 199 (85.4%). Shpesh i shtojnë kripë ushqimit ishin përgjigjur 92 (40.5%) e pacientëve. Vetëm 24 (10.7%) nuk harrojnë të marrin ilaçet me rregull. Tymosin duhan çdo ditë 71 (31.6%) pacientë pjesëmarrës. Sipas Glazer Scale i cili përcakton tipin e personalitetit, tipi A ishin 147 (67.1%), tipi B 43 (19.6%), tipi AB 29 (13.2%). Konkluzion: Përballimi i kësaj sëmundje kërkon të bërit parandalim, këshillim, të kuarit me terapitë e duhura të cilat nuk janë vetëm farmakologjike. Sëmundja e hipertensionit në këtë studim sugjeron që psikologët, infermierët familjar, mjekët familjar duhet të kenë objektivat për uljen presionit të gjakut duke ndryshuar stilin e jetës, me anë të këshillimit lidhur me aktivitetet fizike, rregullimin e ushqyeshmërisë, përmirësimin e veseve si alkooli, pirja e duhanit si dhe përballja me stresin.

Fjalë kyç: *stili i jetës, hipertension arterial, pacient, personalitet*

Hyrje

Hipertensioni shfaqet atëherë kur furnizimi me gjak nëpërmjet enëve të gjakut e kalon masën, duke ushtruar trysni mbi muret e enëve të gjakut. Kur presioni i lartë i gjakut ndodh në mënyrë kronike, ai mund të shkaktoj një fortësim të mureve të arterieve dhe prishjen e sipërfaqes së qelizave. Janë rreth 60 milionë njerëz që vuajnë nga hipertensioni në SHBA dhe çdo vit rreth 16.000 persona vdesin si pasojë e sëmundjes së zemrës nga hipertensioni. Ndërsa në Kosovë 77% e popullatës vuajnë nga hipertensioni, kjo sëmundje paraqet 57% të shkaqeve të vdekjes në Kosovë.

Ka disa faktorë që ndikojnë në tensionin e gjakut si për shembull, volumi i ujit në trup, përmbajtja e kripës në trup, hormonet, niveli i aktivitetit, temperatura, gjendja emocionale, gjendja e veshkave, sistemit nervor dhe enëve të gjakut. Në qoftë se tensioni i gjakut është i lartë dhe nuk vihet nën kontroll, zemra dhe arteriet nuk funksionojnë ashtu siç duhet. Hipertensioni kryesor (*parësor*) nuk ka ndonjë shkak të njohur. Ky lloj hipertensioni gjendet në pothuajse 95% të të gjithë pacientët me hipertension. Megjithëse shkak nuk është i qartë, faktorë gjenetik dhe të mjedisit, të tillë si dieta dhe aktiviteti fizik luajnë një rol të rëndësishëm. Hipertensioni *dytësor* është tensioni i lartë i gjakut i cili shkaktohet nga një çrregullim bazë, siç janë: Ngushtimi i arterieve të caktuara, çrregullimet e gjëndrës mbiveshkore, çrregullimet e veshkave, përdorimi i ilaçeve apo kimikateve të tjera, shtatëzania, përdorimi i kontraktivëve nga goja, antihistaminës, steroideve, ilaçeve kundër depresionit ose ilaçeve anti-inflamatore josteroidale, çrregullime dhe sindroma të tjera të ngjashme.

Kujdesi ndaj ushqyeshmërisë, zvogëlimi i përmbajtjes së yndyrës në dietë është hapi i parë në zvogëlimin e nivelit të kolesterolit. Shkala e I-rë e dietës sipas Shoqatës Amerikane të Zemrës jep 30% më pak kalori totale prej yndyrës. Jo më shumë se 10% e kalorive duhet të krijohet prej yndyrës së ngopur, dhe jo më shumë se 300 mg kolesterol në ditë duhet konsumuar. Frenimet shumë të rrepta mund të zvogëlojnë konsumimin nga personat e moshuar të mineraleve dhe vitaminave adekuate dhe nuk është zakonisht e rekomanduar. Konsumimi i një diete të pasur me fruta, perime dhe përmbajtje të ulët yndyrnash mund të çojë në uljen e presionit prej 8-14 mmHg. Reduktimi i përmbajtjes së kripës në dietën ditore në jo më shumë se 100 mmol (= 6 g klorur natriumi) mund të ulë vlerat e presionit prej 2-8 mmHg. (Lueckenotte A.G., 2000). Kontrolli i peshës nuk është vetëm i të ushqyerit lidhur me vdekshmërinë në rritje të përqindjes së sëmundjes kronike. Vetë dieta ka qenë fokusi i shqetësimit. Siç dihet kripa është e lidhur me hipertensionin dhe sëmundjet kardiovaskulare niveli i lartë i dhjemit dhe kolesterolit janë të lidhur me sëmundjet koronare të zemrës.

Menaxhimi dhe kontrolli i shtypjes së lartë të gjakut përfshin mundësinë e ndryshimit të stilit të jetës, mundësia e stilit të jetesës përfshin ndryshimin e asaj çka hani dhe nivelin e aktivitetit. Ndryshimi i pirjes së duhanit dhe marrja e moderuar e alkoolit gjithashtu do të ndihmojë në mbajtjen e shtypjes së gjakut në kufij të mirë (shëndetshëm). Mban peshën e shëndetshme, nëse je mbipeshë ose obezë, humbe peshën, jepi qëllim nivelit të peshës së shëndetshme për gjatësinë tuaj dhe llojin e trupit. Edhe një humbje e vogël e peshës mund të bëjë ndryshime madhore në zvogëlimin ose parandalimin e shtypjes së lartë të gjakut. Për të humbur peshën, ju duhet të hargjoni më shumë kalori sesa merrni. Dietat dështuese ose në modë nuk janë të dobishme (ndihmuese) dhe mund të jenë të rrezikshme. Humbja më e shëndetshme dhe më jetëgjatë e peshës kërkon humbjen e ngadalshme, sikurse është humbja e një gjysme deri në një pound në secilën javë. Ngrënia prej 500 kalori më pak se sa ju i harxhoni për çdo ditë mund të ndihmojë për të arritur këtë qëllim. Në një javë, ju do të hani 3500 kalori më pak se sa ju i harxhoni, e cila është e mjaftueshme për të humbur 1 pound. Rritja e aktiviteteve fizike do të ju ndihmojë që të digjni më shumë kalori. Zgjidh ushqimin me më pak kalori dhe yndyrna. Yndyra është burim i koncentruar i kalorive. Ju duhet të pakësoni gjalpin, margarinën, salcat e rregullta për sallat, mishin e yndyrshëm ose të kuq, lëkurën e shpendëve, marrjen e shumtë të qumështit, djathit, ushqimet e fërguara (skuqura), akulloret, shumë biskota (ëmbëlsira), torte, pastave dhe mezeve. Më mirë, zgjedh pulë pa lëkur dhe gjel deti (pa lëkur) të pjekur, të skarës, peshk, mbështet prerjet e mishit (sa një filet ose kundër filet) qumësht me shkumë 1% ose të zhdukur fare, djath me pak yndyrë dhe pak kripë (sodium), pemë ose perime të freskëta, të ngrira ose të konservuara (pa gjalpë, kajmak ose salcë djathi) oriz të fushës dhe pasta (brumëra, makarona) kiflet (simitet) gjevrekët, buka dhe petëzat e sanduiçit. Drithërat në përgjithësi të ftohta dhe të nxehta largojnë llojeve të "çastit", të cilat janë me sodium të lartë. (7, 14).

Zgjedh ushqimin me nisheste dhe fibër të lartë. Këto ushqime janë të dobëta me yndyrë dhe gjithashtu burim i mirë i vitaminave dhe mineraleve. Provo pemët, perimet, drithërat në përgjithësi, pastat, orizin dhe bizele të thatë. Kufizimi i madhësisë së shërbimeve kryesisht duhet të provoni të merrni porcione të vogla të ushqimit me kalori të lartë sikurse që është mishi dhe djathi. Provo ti largohesh joshjes së kthimit mbrapa. Shëno se çka hanë dhe kur kjo mundë të jetë ndihmuese për krijimin e shprehisë. Ju duhet të shënoni se ku jeni dhe se çfarë bëni kur merrni pjesë në ushqime me kalori të larta. Për shembull, shumë njerëz marrin pjesë gjersa shikojnë televizion ose e kaloni mëngjesin dhe pastaj hanë një drekë të madhe? Identifikimi i modelit të të ngrënit tuaj mund të ju ndihmojë që ta mposhtni gjendjen në të cilën ju hani tepër. Zëvendëso kaloritë e larta, pjesët me yndyrë të lartë me fruta të freskëta, kokoshka (popcorn) të ajrosura (pa kripë ose djathë) ose gjevrek të pa kryposur. Nëse nuk keni kohë për mëngjes, merr një kiflet (simit) me pakë yndyrë, një gjevrek (pa djathë) ose drithëra përgjatë punës. Kjo do të ul dëshirën për një drekë të madhe. (1, 2, 14)

Kujdesi ndaj konsumimit të alkoolit - Për 8 vite studim, të shikuara më shumë se 70,000 gra të moshës 25-42 vjeçe është gjetur se ato të cilat kishin pirë rreth dy ose tri pije në javë e kishin 15% rrezikun më të vogël për zhvillimin e shtypjes së lartë të gjakut sesa ato që nuk kishin pirë fare. Por për gratë të cilat kanë pirë më shumë, janë zvogëluar përfitimet dhe shtypja e gjakut ka filluar të rritet me konsumimin e më shumë se 1.5 pije në ditë. Gratë të cilat kanë pirë mesatarisht 10 pije ose më shumë në javë kanë pasur 30% rrezik më të madh për zhvillim të shtypjes së lartë të gjakut. Abuzimi me alkoolin numëron çdo vit me mijëra vdekje dhe billiona dollarë humbje ekonomike. Në mënyrë origjinale është konsideruar si një sëmundje sociale,

alkooli është njohur në rrugë zyrtare si një ndikues në sëmundje nga Asociacioni mjekësor Amerikan (1957) (Jellink 1960). Kjo ngritje e shtypjes së gjakut është parë me verë, birra dhe liker (Thadhani R., 2002)

JNC 7 gjithashtu rekomandojnë që pacientët meshkuj të mos konsumojnë më shumë se dy pije alkoolike në ditë dhe pacientët femra jo më shumë se 1 pije në ditë. Kufizimi i konsumimit të alkoolit mund të zvogëlojë SHSGJ-në prej 2 deri 4 mmHg.

Stili i jetesës i ulur është një tjetër faktor i ndryshueshëm i rrezikut kardiak. Stili jetësor i ulur njihet për më shumë se 25.000 vdekje në vit (Maron, Rader, 1998). Ushtrimet aerobike sikurse ecja e shpejtë e shton nivelin e HDL zvogëlon nivelin e LDL, zvogëlon shtypjen e gjakut, rritë mirëqenien dhe e zvogëlon stresin (Halm, Penque, 1999). Shoqata Amerikane e Zembrës (The American Heart Association – AHA) rekomandon 30 minuta me ushtrime të intensitetit të moderuar katër deri pesë herë në javë. Profesionistët e kujdesit shëndetësor duhet të inkurajojnë ushtrimet dhe të promovojnë mënyrën për të rritur aktivitetet në rutinën ditore.

Obeziteti është një faktorë tjetër i ndryshueshëm i rrezikut kardiak. Obeziteti është zakonisht i shoqëruar me stil jetësor të ulur dhe dietë me yndyrë të rritur, e cila e shton paraqitjen e rrezikut kardiak individual.

Kujdesi ndaj aktiviteteve fizike - Shoqata Amerikane e Zembrës rekomandon 30 minuta me ushtrime të intensitetit të moderuar katër deri pesë herë në javë. Profesionistët e kujdesit shëndetësor duhet të inkurajojnë ushtrimet dhe të promovojnë mënyrën për të rritur aktivitetet në rutinën ditore. Rruga për të inkurajuar këtë përfshin parkimin e veturës pak përpara prej derës së dyqanit, ecja shkallëve poshtë ose lartë për një kat ose ecja për në zyrë nëse ajo është afër. Është e rekomanduar që çdo njëri i cili fillon me programin e ushtrimeve duhet të konsultohet me mjekun për të mësuar më shumë rreth aktiviteteve fizike dhe përshtatshmërisë kardiovaskulare. Një aktivitet fizik, siç është p.sh. ecja normale për të paktën 30 minuta në ditë, çon në një ulje të presionit prej 4-9 mmHg. Aktiviteti fizik i djegë kaloritë, ndihmon në humbjen e peshës dhe zvogëlon stresin. Aktiviteti fizik gjithashtu zvogëlon kolesterolin total dhe kolesterolin e keq (LDL) dhe ngrit kolesterolin e mirë (HDL).

Aktiviteti fizik nuk e ka kuptimin e vrapimit të gjatë në gara. Pastrimi i shtëpisë ose të luajturit golf apo bejsboll mund të djeg deri 300 kalori në orë, të ecurit e gjallë (në 3.5 mph), çiklizmi (në 5.5 mph), kopshtari, vallëzimi ose luajtja basketboll djeg më shumë se 450 kalori në orë, vrapimi me ecje të shuar (9 min/ mile), luajtja futboll ose notimi mund të djeg më shumë se 730 kalori në orë dhe vrapimi (7 min/mile), tenisi, skijimi mund të djegin më shumë se 920 kalori në orë. Ju mundë ti përshtatni aktivitetet fizike në rutinën tuaj ditore duke i përdorur shkallët në vend të ashensorit, duke zbritur nga autobusi 1 apo 2 vend ndalime më herët dhe ec rrugës në qetësi, duke parkuar më larg nga dyqani apo zyra, duke ngarë biçikletën, duke punuar në oborr apo kopsht, duke pastruar shtëpinë, duke pastruar veturën në mënyrën e modës vjetër, duke vallëzuar etj. (5, 9, 10).

Stresi është menduar për shumë vjet si një kontribues për hipertensionin (Henry Cassel, 1969). Provat e rëndësishme lidhin ngritjet e nivelit të presionit të gjakut me ngjarjet stresuese (Harrel, 1980; Goldstein, 1982). Një literaturë e gjerë eksperimentale tregon se faktorë stresantë të krijuar në laboratorë duke përfshirë mbajtjen e frymës, drita të forta vezulluese, pyetje emocionalisht shqetësuese, teste aritmike, injeksione dhe goditje elektrike, të gjitha shkaktajnë rritje të presionit të gjakut (Shapiro Goldstein, 1982). Këto efekte janë shfaqur edhe tek të bardhët edhe tek zezakët (Anderson et al., 1986). Reagime ndërmjet rritjes së presionit të gjakut ndaj shkatërrimeve natyrore ose jo natyrore, janë vënë re në pjesë të ndryshme të popullatës si p.sh. ushtarët gjatë manovrave në shkretëtirë (Graham, 1945) dhe rezidentëve gjatë një shpërthimi kimik (Ruskin, Beard Schaeffer, 1948). Vendet e mbipopulluara, stresante dhe të zhurmshme, shkaktajnë nivele më të larta të hipertensionit (James, 1987). Gjithashtu, stresi gjatë punës dhe papunësia kanë lidhje me tensionin e lartë. Hipertensionin është çrregullim serioz në kuadër të mjekësisë familjare paraqet gjendjen më të shpeshtë e cila kërkon mjekim medikamentoz afatgjatë. Është një vrasës tinar pasi që shumica e njerëzve me hipertension janë asimptomatik dhe nuk janë në dijeni për problemën e tyre. Studimet epidemiologjike kanë dëshmuar për lidhshmërinë në mes të hipertensionit dhe insultit, sëmundjeve koronare të zemrës, sëmundjeve të veshkës, insuficiencës së zemrës. Trajtimi është gjatë tërë jetës, prandaj nevojitet një menaxhim i kujdesshëm. (Qendra për zhvillimin e mjekësisë familjare të Kosovës Moduli i gjashtë, Prishtinë, 2012)

Konsumimi i duhanit vazhdon të jetë faktor madhor i rrezikut në zhvillimin e sëmundjeve të zemrës. Megjithatë është bërë një rënie në përdorimin e duhanit, kryesisht si fushat e promovimit të shëndetit, ajër i pastër i ambientit, pirja e duhanit është ende e ngarkuar me 30% e të gjitha vdekjeve. Konsumuesit e duhanit kanë dy herë rastësi të sëmundjeve të arterieve koronare kontraktuese dhe katër herë rastësi për vdekje të befasishme sesa jo konsumuesit (Keller, Lemberg, 1996).

Qëllimi i punimit ishte të kuptojmë ndikimin e stilit të jetës te pacientët me hipertension arterial dhe identifikimi i njohurive të këtyre pacientëve lidhur me faktorët kontribues për shfaqjen e kësaj sëmundje në rajonin e Prizrenit.

Metodologjia

Në këtë hulumtim janë përfshirë 233 pacientë me hipertension arterial në regjionin e Prizrenit, Kosovë. Mbledhja e të dhënave dhe dizajni: Ky studim ishte i tipit cross sectional dhe me natyrë përshkruese. Metoda e mbledhjes së të dhënave është e bazuar në intervistat personale dhe ekzaminimet fizike (matjet antropometrike dhe të shtypjes së gjakut). Mbledhja e të dhënave është bërë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prizren dhe në Ambulancën Private “Nderimet” në Zhur. Përzgjedhja e pacientëve është bërë në mënyrë të randomizuar nga të cilët është kërkuar të plotësohet pyetësori standard i gjysmë-strukturuar i përkthyer në gjuhën shqipe (Life Style Questionnaire and Perceived Stress Scale, 2008). Me anë të këtij pyetësori janë marrë të dhëna për karakteristikat socio-demografike të pjesëmarrësve, modelet e dietës dhe stilit të jetesës. Në

pyetësor janë përfshirë 24 pyetje lidhur me shprehitë e ushqyeshmërisë p.sh., “Cilat prej vakteve kryesore të ditës hani”, “Sa vakte ushqimore hani”, “Sa herë në javë hani mish, peshk, djathë” etj. Gjithashtu janë përfshirë pyetjet lidhur me shprehinë e pirjes, p.sh. “Sa shpesh tymosni”, “Sa shpesh konsumoni alkool” etj. Pastaj janë përfshirë 13 pyetje për aktivitetin fizik siç janë: “Sa herë në javë ecni në këmbë ose me biçikletë”, “ Sa ndiheni të motivuar për të bërë ushtrime” etj. Stresi është matur me tre grupe me nga 10 pyetje të shkallëzuara me dhjetë mundësi zgjedhje. Rezultati më i lartë sugjeron nivel më të lartë të stresit. Tipi i personalitetit është matur me dy tipare, përcaktimi i tipit të personalitetit A (tipi A përfshinë ata njerëz të cilët janë në luftë të vazhdueshme për të bërë sa e sa më shumë gjëra në sa më pak kohë. Ne përgjithësi bëhen agresiv në përpjekjet e tyre për të arritur qëllimin, janë gjithnjë nën presionin se s’u del koha dhe kanë gjithmonë një afat për të dorëzuar gjërat. Ata marrin jetën shumë seriozisht dhe jeta e tyre karakterizohet nga konkurrenca dhe ambicia. Janë të paduruar, impulsivë dhe shumë të tensionuar, këto individë janë kështu gjithë kohën madje edhe në kohë relaksi). Njerëzit të cilët nuk shfaqin këto karakteristika futen në tipin B, ata janë të aftë të pushojnë, nuk merakosen për kohën dhe janë më të kënaqur me veten, është bërë duke vlerësuar përgjigjet nga 10 mundësitë e zgjedhura, më afër 0 paraqiste tipin B dhe më afër 10 paraqiste tipin A. Pyetjet ishin lidhur me komunikimin, shprehjen e ndjenjave, bërjen e punëve etj.


Analizimi i të dhënave: të dhënat janë analizuar duke shfrytëzuar SPSS programin, versionin 21. Paraqitja e frekuencës është bërë në tabela, gjithashtu janë realizuar tabelat e kryqëzuara për të paraqitur relacionet ndërmjet kategorive të ndryshoreve. Chi-square testi është përdorur për të krahasuar diferencën ndërmjet proporcioneve. Analiza regresive logjistike është përdorur për të përcaktuar ndryshoret që paragjykojnë statusin e ushqyeshmërisë dhe hipertensionit tek pjesëmarrësit. Të gjitha analizat statistikore janë përcaktuar në nivelin e signifikancës 5% ($p < 0.05$).

Konsiderata etike. Fillimisht është marrë pëlqimi me shkrim nga drejtoria e qendrës ku do të zhvillohej intervista, në këtë rast në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prizren dhe në ambulancën private “Nderimet” në Zhur. Po ashtu edhe të gjithë pjesëmarrësve u është marrë pëlqimi gojor për mundësinë e pjesëmarrjes në hulumtim dhe pastaj janë dhënë sqarimet lidhur me procedurën. Intervista është zhvilluar në kushte anonimiteti sepse nuk është kërkuar që ata të identifikohen në asnjë mënyrë dhe pjesëmarrësit ishin të rastësishëm.

Rezultatet

Sa i përket përfaqësimit të gjinisë 109 (47%) ishin meshkuj ndërsa 124 (53%) femra. Shumica e pjesëmarrësve 158 (67,8%) ishin me shkollim fillor. Grup mosha më e prekur ishte ajo mbi 65 vjeç (45.5%) pastaj grup mosha 55-64 vjeç (30.9%). Sa i përket statusit martesor, 181 (77,7%) nga pjesëmarrësit ishin të martuar, përderisa 1 (0,4%) ishte i pamartuar, 4 (1,7%) ishin të divorcuar dhe 47 (20.2%) ishin të ve.

FIGURA 1. NIVELI I TENSIONIT ARTERIAL



Nga gjithsej 233 pjesëmarrës në studim 18 (7.7%) nuk kanë dhënë përgjigje dhe gjithashtu nuk janë përfshirë në analizë. 3 (1.4%) kishin të normalizuar shtypjen e gjakut (Sh Gj), 26.5% kishin hipertension të stadi të parë, 34.4% e pjesëmarrësve kishin hipertension të stadi të dytë dhe 37.7% kishin hipertension të rëndë.

TABELA 1. GJINIA * BMI CROSS TABULATION

Normal		BMI			Total
		Normal	Mbipeshë	Obez	
Gjinia	Mashkull	21	37	49	107
	Femër	25	55	36	116
Total		46	92	85	223

Prej 233 pjesëmarrësve, 10 nuk kanë dhënë përgjigje në të dhënat të cilat pastaj do të na tregonin neve vlerat e IMT (Indeksi i Masës Trupore), nga 107 meshkuj 21 ishin me peshë normale, 37 ishin mbipeshë dhe 49 ishin obezë, përderisa nga 116 femra 25 ishin me peshë normale, 55 ishin mbipeshë dhe 36 obezë.

TABELA 2. SA VAKTE USHQIMORE HANI NË DITË GJITHSEJ?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	1	.4	.5	.5
	2	35	15.7	16.3	16.7
	3	130	58.3	60.5	77.2
	4	48	21.5	22.3	99.5
	5	1	.4	.5	100.0
	Total	215	96.4	100.0	
Missing	99	6	2.7		
	System	2	.9		
	Total	8	3.6		
Total		223	100.0		


Në pyetjen “Sa vakte ushqimore hani në ditë gjithsej?”, shumica nga pjesëmarrësit 179 (83.3%) hanin tri vakte apo më shumë në ditë.

FIGURA 2. SA SHPESH I SHTONI KRIPË USHQIMIT TUAJ?




Lidhur me shprehinë e të ngrënit, rezultatet treguan që 59.5% nga mostra e studiuar rrallë shtonin kripë ushqimit të tyre ndërsa 40.5% shpesh i shtonin ushqimit të tyre kripë.

FIGURA 3. ÇFARË LLOJ YNDYRNASH PËRDORNI PËR GATIM APO SPËRKATJE (P.SH. MAKARONAT, PATATET, SALCAT ETJ.)



Siç po shihet në figurën 3, shumica e pjesëmarrësve 219 (96.5%) normalisht përdorin vaj, margarine apo gjalpë për gatim apo spërkatje.

FIGURA 4. KONSUMIMI I ALKOOLIT



Bazuar në të dhënat e këtij studimi, në figurën 4 shihet që shumica e pjesëmarrësve 92% nuk janë konsumues të alkoolit. Siç shihet edhe në figurën 5 shumica e pjesëmarrësve 56.6% ishin të motivuar që të humbnin peshën e tyre, përkundër këtij motivi në pyetjen e bërë se a bëjnë ushtrime të rregullta vetëm 7 (7.8%) e pjesëmarrësve janë përgjigjur pozitivisht (figura 6). Sa i përket marrjes së ilaçeve, vetëm 24 (10.7%) pjesëmarrës nuk harrojnë të marrin ilaçet me rregull, ndërsa sipas Emedicine consumer health, High Blood Pressure, Self-care at home - 2005 “një nga sfidat më të mëdha në trajtimin e shtypjes së gjakut është marrja e barnave në mënyrë të kontrolluar dhe afërsisht 28% i marrin barnat gabimisht dhe shtypja e tyre e gjakut është e pakontrolluar”. Ndërsa lidhur me pirjen e duhanit çdo ditë tymosin duhan 71 (31.6%) pjesëmarrës. Këto të dhëna tregojnë qartë se shtypja e tyre gjakut është e pa kontrolluar dhe mundësia për marrjen e gabueshme të barërave është e evidente te shumica. Edhe kjo e dhënë besohet që përputhet me nivelin e shkollimit të subjekteve siç është cekur në rezultate (67,8% e subjekteve ishin me shkollim fillor).

FIGURA 5. A DËSHIRONI TË HUMBISNI PESHË?





TABELA 3. A NDIHENI ZAKONISHT MOTIVUAR PËR TË BËRË USHTRIME FIZIKE?

	N	Min	Max	Mean	Std. Deviation
A ndiheni zakonisht i motivuar për të bërë ushtrime?	86	1.00	4.00	1.8605	.82836
Valid N	86				

FIGURA 6. A BËJNË RREGULLISHT USHTRIME FIZIKE?




Sa i përket aktiviteteve fizike 68% nga mostra e hulumtuar raportuan se ata merren më pak se një orë me ndonjë aktivitet, ndërsa siç është e demonstruar edhe në tabelën 1, shumica e pjesëmarrësve ishin shpesh të motivuar (Mean=1.86, ku 1 nënkupton gjithnjë, 2 shpesh, 3 ndonjëherë dhe 4 asnjëherë) për të bërë ushtrime, por që në realitet ata nuk bënin ushtrime (92.2% kishin thënë jo, demonstruar në figurën 6).

Sipas Glazer Scale i cili përcakton tipin e personalitetit në figurën 7 shihet që persona të tipit A ishin 147 (67.1%), të tipit B 43 (19.6%) dhe të tipit AB 29 (13.2%).


Lidhur me stresin, rezultatet nuk kanë treguar dallim significant/shenjues të gjinisë në nivelin e stresit, kështu që meshkujt dhe femrat kanë raportuar nivele të ngjashme të stresit. Gjithashtu nuk ishin gjetur dallime signifikante/shenjuese në marrëdhëniet ndërmjet stresit dhe moshës. Variacionet e statusit martesor gjithashtu nuk kishin kontribuar për të shpjeguar nivelet e stresit, kjo e gjetur mund të ketë e lidhur me mungesë të variacionit (shumica e pjesëmarrësve ishin të martuar). Ngjashëm niveli i arsimimit nuk ishte i lidhur me nivelin e stresit të raportuar, e që gjithashtu kjo e dhënë mund të jetë e lidhur me variacionin e vogël në këtë ndryshore (p.sh. shumë pak kishte me nivel të lartë të arsimimit). Ndryshorja e vetme e lidhur me nivelin e stresit është gjetur tipi i personalitetit, $r=0.32$, $p<0.05$. Kështu tipi A i personaliteti ka raportuar të ketë nivel më të

FIGURA 7. PARAQITJA E PERSONALITETI SIPAS GLAZER SCALE



lartë të stresit krahasuar me tipin e personaliteti B, veçanërisht në dallimin në mes gjinive, shumica e pjesëmarrësve ishin të tipit A (vetëm 14% femra dhe 15% të meshkujve ishin tipi B i personaliteti). Gjithashtu në studim është vërejtur që shumica nga pjesëmarrësit (53.6%) kanë shprehur ndjenjat e tyre gjithnjë me nervozizëm dhe ankth.

FIGURA 8. TIPI I PERSONALITETIT



Konkluzione

Gjetjet në këtë punim janë mjaft shqetësuese në aspektin e sjelljeve shëndetësore të shfaqura nga pacientët me hipertension. Pacientët shihet se kanë shprehur jo të mira të ushqyeshmërisë dhe pijes, merren shumë pak me ushtrime fizike edhe pse shumica e tyre janë të motivuar, ata kanë nevojë për të ndryshuar shprehjet apo stilin e jetesës.

Megjithatë nuk është e qartë nga të gjeturat e studimit nëse ky stil i jetës te pacientët e sëmurë është për shkak të mungesës së njohurive (ata nuk janë të arsimuar në lidhje me stilin e jetesës lidhur me ushqimin e shëndetshëm, pijen, aktivitetin fizik, përballimin e gjendjeve stresuese, dhe kryesisht janë pacientë të grup moshës mbi 65 vjeç), por kur kemi pyetur pjesëmarrësit nëse ata ishin të motivuar për të humbur peshën e tyre (fig. 5 .) shumica prej tyre ishin të motivuar për të humbur peshën (pavarësisht dijes).

Për më tepër, përfshirja e faktorëve të veçantë të kulturës gjithashtu mund të shqyrtohen p.sh., mishi i kuq duke qenë pjesë e dietës tipike në Kosovë. Megjithatë këto rezultate sugjerojnë nevojën për të informuar dhe edukuar pacientët në vijim për një dietë të përshtatshme, për ushqim të shëndetshëm, të pirit dhe aktivitetet fizike, aspekte të cilat janë vendimtare në mbajtjen e gjendjes nën kontroll. Sipas rekomandimeve të JNC-7 marrja me aktivitete fizike të rregullta siç është ecja e shpejtë së paku

30 minuta në ditë, 4-5 ditë në javë, zvogëlon shtypjen sistolike të gjakut prej 4-9 mmHg. Është vërejtur se nga subjektet që e preferojnë ecjen atë e bëjnë në kuadër të kryerjes së punëve tjera dhe jo si mënyrë e kujdesit ndaj shtypjes së lartë të gjakut.

Sipas IMT (indeksi i masës trupore) të pacientëve rezultoi se shumica e pjesëmarrësve ishin mbipeshë apo obezë, ky rezultat është i lidhur me një pyetje tjetër (tab 2.) ku 83,3% kanë raportuar se hanë tre ose më shumë vakte në ditë dhe shumica e tyre të paraqitura në figurën 4 (96,5%) përdorin vaj, margarinë ose gjalpë për gatim.

Në pyetjen “Sa shpesh ju shtoni kripë në ushqimin tuaj?” Rezultatet treguan se 59,5% nga mostra e studiuar rrallë shtonin kripë ushqimit të tyre ndërsa 40.5% shpesh i shtonin ushqimit të tyre kripë. Këto gjetje rreth stilit të jetës që duhet të ndryshojë janë të ngjashme me shqyrtim të literaturës. [12, 13]

Ky stil jetës duket që do të jetë me rrezik të lartë për zhvillimin e rasteve të hipertensionit në popullatën tonë, edhe kjo epidemi në rritje e obezitetit, si faktor kryesor rreziku për zhvillimin e hipertensionit dhe problem tjetër serioz shëndetësor është vërejtur gjatë shqyrtimit të literaturës [3, 4].

Gjatë shqyrtimit të literaturës është vërejtur se alkooli ishte i lidhur në mënyrë të konsiderueshme me presionin e lartë të gjakut [3, 5]. JNC 7 rekomandon që personat meshkuj të mos konsumojnë më shumë se dy pije alkoolike në ditë dhe personat femra jo më shumë se 1 pije në ditë. Ndërsa në studimin tonë (fig. 4.) shumica e pjesëmarrësve ishin jo-konsumues të alkoolit. Këto gjetje janë të përafërta edhe me gjetjet e Marečková J. të kryera në Çeki ku thuhet se vetëm 10% e subjekteve kanë konsumuar alkool. Mund të konkludojmë se kjo dukuri në vendin tonë ka të bëjë më shumë me traditën dhe besimin fetar sesa me vet-kujdesin për hipertension.

Pirësit e duhanit kanë dy herë rastësi më të mëdha të sëmundjeve të artereve koronare kontraktuese dhe katër herë rastësi për vdekje të befasishme sesa jo konsumuesit sipas Keller, Lemberg, 1996. Nga rezultati i hulumtimit tonë del se pirja e duhanit nuk është problem madhor në vendin tonë sepse vetëm 31,6% janë pirës aktivë të duhanit çdo ditë.

Nuk ka dallime të mëdha gjinore te gjetura në nivelet e stresit të raportuar duket se edhe pse burrat dhe gratë mund të përjetojnë lloje të ndryshme të streseve, nivelet e përgjithshme të përjetuara nga të dy janë të ngjashme. Gjithashtu marrëdhënie të rëndësishme u gjetën në mes stresit dhe moshës, pavarësisht nga gama e gjerë e moshës prej gati 30 vjet (45-74 vjeç). Ndryshimet në statusin martesor gjithashtu nuk kontribuuan për të shpjeguar nivelin e stresit, një gjetje e cila nuk është në përputhje me hulumtimin e sugjeruar, një rol të rëndësishëm në zbutjen e raporteve mes partnerëve kundër stresit. Megjithatë këto rezultate mund të ketë një shpjegim statistikor, pasi që mund të jetë për shkak të mungesës së variacionit të mostrës; në të vërtetë shumica e pjesëmarrësve ishin të martuar (77,7%), i/e pa martuar vetëm një ishte (0,4%), të divorcuar ishin 1,7% dhe të ve 20,2%. Më në fund hipoteza që është konfirmuar ishte ajo e marrëdhënies ndërmjet llojit të personalitetit dhe stresi gjetjet në këtë studim janë në përputhje me literaturën ekzistuese mbi marrëdhëniet në mes të personalitetit të tipit A dhe nivelit të stresit. Për më tepër pjesa më e madhe e mostrës duket të jetë personaliteti i tipit A, një gjetje e cila në mënyrë të qartë ka nevojë për t'u konsideruar seriozisht. Në të vërtetë këto rezultate sugjerojnë nevojën për të trajtuar karakteristikat e veçanta të personalitetit të pacientëve në përpjekje për të reduktuar stresin dhe për të kontrolluar tensionin e lartë. Megjithatë këto rezultate sugjerojnë nevojën për të informuar dhe edukuar pacientët në vijim për një dietë të duhur, regjim të aktivitetit fizik, menaxhimin e stresit, aspekte të cilat janë vendimtare në mbajtjen e gjendjes nën kontroll.

Përballimi i kësaj sëmundje kërkon të bërit parandalim, këshillim, të kuararit me terapitë e duhura të cilat nuk janë vetëm farmakologjike. Sëmundja e hipertensionit në këtë studim sugjeron që psikologët e shëndetit, punonjësit social, infermierët familjar, mjekët familjar duhet të kenë objektivat për uljen presionit të gjakut duke ndryshuar stilin e jetës, me anë të këshillimit lidhur me aktivitetet fizike, rregullimin e ushqyeshmërisë, përmirësimin e veseve si alkooli dhe pirja e duhanit si dhe përballja me stresin.

Mbështetur në rezultatet e hulumtimit, diskutimet dhe komentet e shumta që na u thanë gjatë intervistave të zhvilluara rekomandojmë që: ofruesit e kujdesit shëndetësor në çdo takim me persona që kanë predispozita për hipertension ose me ata që vuajnë nga kjo sëmundje, edukimi mbi vet-kujdesin dhe ndryshimin e stilit të jetës të bëhet metodë e domosdoshme si mënyrë efektive e parandalimit nga përkeqësimi i sëmundjes.

Implikimet janë të qarta për profesionistët shëndetësor që merren me këta pacientë, veçanërisht në ofrimin e këshillave për stilin e jetës dhe mbështetjen sociale. Në këtë kontekst hulumtimi i ardhshëm mund të sugjerohet që të hetohen arsyet e vërteta e këtyre gjetjeve sidomos në aspektin e roleve që profesionistët shëndetësor kanë në këtë proces për profesionistët e shëndetit. Për të përfunduar, pavarësisht nga kufizimet (mostër të vogël, të dhënat përshkruese etj.) studimi ofron disa udhëzime të rëndësishme për kërkime në të ardhmen.

Bibliografia

- World Health Organization, Diet and physical activity: a public health priority [online], available from <http://www.who.int/dietphysicalactivity/en/>
- National Institute of Health (NIH) / National Heart, Lung and Blood Institute (NHLBI) (2006). Your guide to lowering your blood pressure. DASH eating plan. US Department of Health and Human Services. Available at: <http://www.nhlbi.nih.gov/health/public/heart/hbp/dash/>
- Bytyqi R, Bytyqi A, “Kuptimi i vet-kujdesi te pacientet ambulator me hypertension”, supervised by Prof. Dr. Andrew Sirka, Raili Kurki BSN, MSN. Maj 2007, Prishtine.
- Juriková J, Novotná E, Šitinová M. “Eating habits and frequency of physical activity in hypertonic patients”, bromat. Chem. TOKSYKOL. – XLV, 2012, 3, str. 1035–1038

- Sharman J., Stowasser M., "Australian Association for Exercise and Sports Science Position Statement on Exercise and Hypertension", *Journal of Science and Medicine in Sport* (2009) 12, 252-257.
- National Institute of Public Health of Kosova, Morbidity analyses of population in Kosovo for 2011y (alb.available from http://www.niph-kosova.org/index.php?option=com_jdownloads&Itemid=6&view=view.download&catid=3&cid=58)
- K.M. Ganesh., "Physical activity, dietary habits and blood pressure among hypertensive patients in Phutthamonhon District, Nakornpathom Province, Thailand", Mahidol University, 2009
- Lueckenotte A. G., 2000, Gerontologic Nursing, Second edition
- Pescatello LS, Franklin BA, Fagard R, Farquhar WB, Kelley GA, Ray CA. Exercise and hypertension: American College of Sports Medicine, Position Stand. *MedSci Sports Exerc.* 2004;36:533-52.
- Alsairaf M., Alshamali K., Al-rashed A. "Effect of Physical Activity on Controlling Blood Pressure among Hypertensive Patients from Mishref Area of Kuwait", *Mishref Clinic, Hawalli Health District, Kuwait, Eur J Gen Med* 2010;7(4):377-384
- Ganasegeran K, Al - Dubai SA, Qurechi AM, Al – Abed AA, An R,Aljunaid SM (2012). Social and psychological factors affecting eating habits among university students in a Malaysian medical school: across sectional study. *Nutr. J.* 11:48.
- Volterrani M., Lellamo F. "Effect of exercise training in essential arterial hypertension", *Rev Br as Hiper tens* vol.17(2):68-71, 2010.
- WHO Global status report on alcohol and health. WHO Library Cataloguing -in- Publication Data. World Health Organization, Geneva, Switzerland. 2011. Available at: http://www.who.int/substance_abuse/publications/global_alcohol_report/
- Campbell at all, Lifestyle modifications to prevent and control hypertension, Canadian Medical Association, CMAJ, 1999.
- WHO Obesity and overweight. WHO Fact Sheet. World Health Organization. Geneva, Switzerland. 2013. Available at: <http://www.who.int/mediacentre/factsheet/>
- Trials of Hypertension Prevention Collaborative Research Group. The effects of nonpharmacologic interventions on blood pressure of persons with high normal levels. Results of the Trials of Hypertension Prevention, phase 1 [published erratum appears in *JAMA* 1992;267 (17):2330]. *JAMA* 1992;267: 121320.
- Carroll D, Ring C, Hunt K, Ford G, Macintyre S. Blood pressure reactions to stress and the prediction of future blood pressure: effects of sex, age, and socioeconomic position. *Psychosom Med* 2003; 65:1058-64.
- Nichole R. Lighthall, Michiko Sakaki, Sarinnapha Vasunilashorn, Lin NgaHYPERLINK "<http://scan.oxfordjournals.org/content/7/4/476.short>" \l "aff-1"1, Sangeetha Somayajula, Eric Y. ChenHYPERLINK "<http://scan.oxfordjournals.org/content/7/4/476.short>" \l "aff-1"1, Nicole SamiiHYPERLINK "<http://scan.oxfordjournals.org/content/7/4/476.short>" \l "aff-1"1 and Mara MatherHYPERLINK "<http://scan.oxfordjournals.org/content/7/4/476.short>" \l «aff-1»1,4 Gender differences in reward-related decision processing under stress. *Soc Cogn Affect Neurosci* (2012) 7(4): 476-484.)
- Chobanian AV, Bakris GL, Black HR, Cushman WC, Green LA, Izzo JL Jr, Jones DW, Materson BJ, Oparil S, Wright JT Jr, Roccella EJ, December 2003, The Seventh Report of Joint National Committee on Prevention, Detection, Evaluation, and Treatment of High Blood Pressure
- Peggy A. (2013) *ThoitsSelf, Identity, Stress, and Mental Health Handbook of the Sociology of Mental Health* pp 357-377.
- Social and Cultural Aspect of Drinking, A report to the European Commission, March, 1998

NDËRMJETËSIMI FAMILJAR: MODELET KRYESORE TË PROCESIT TË NDËRMJETËSIMIT FAMILJAR NË KONTEKSTIN E KULTURËS SHQIPTARE

KLODIANA RAFTI

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, Psikologji

ABSTRAKT

Ndërmjetësimi familjar është propozuar si një qasje alternative në menaxhimin e konflikteve tek çiftet gjatë divorcit, ku një person i tretë, i paanshëm, i quajtur ndërmjetës, vepron që të lehtësojë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve. Objektivi i procesit të ndërmjetësimit është të ndihmojë palët në reduktimin e aspekteve destruktive të konfliktit, me qëllim përmirësimin e kanaleve të komunikimit në mënyrë që të arrijnë një marrëveshje. Disa ndërmjetës familjarë punojnë në kuadrin e një modeli specifik të ndërmjetësimit. Edhe pse të ndryshëm ndërmjet tyre, qëllimi i secilit model është të ndihmojë çiftin në krizë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në menaxhimin e stresit dhe në rritjen e cilësisë së jetesës. Literatura botërore njih disa modele kryesore ndërmjetësimi, sikurse janë Modeli Struktural i Coogler-it, Modeli Transformativ i Bush dhe Folger, Modeli Global i Haynes, Modeli Terapeutik i Irving dhe Modeli i Integruar i Emery-it. Secili nga këto modele tregon rrugën e vet të procesit të ndërmjetësimit, duke dhënë qasje të ndryshme drejt procesit të pajtimit të çifteve, por, natyrisht, jo të gjitha modelet mund të jenë të suksesshme për t'u zbatuar në kontekstin e çdo kulture dhe tipologjie individësh në këtë drejtim. Ky punim analizon këtë problem duke pasur parasysh disa tipare dalluese që karakterizojnë modelet e ndërmjetësimit familjar lidhur me përballjen e konflikteve të çifteve gjatë divorcit dhe përpiqet të argumentojë dhe propozojë se cilat nga modelet e lartpërmendura janë më të përshtatshme në shuarjen e konflikteve dhe arritjen e marrëveshjeve. Punimi mbështetet në analizën e karakteristikave apo tipareve dalluese të modeleve të ndërmjetësimit prej nga rrjedhin edhe propozimet për modelet më të përshtatshme të ndërmjetësimit.

Fjalë kyç: *ndërmjetësimi familjar, divorci, konflikti, modelet e ndërmjetësimit, konteksti shqiptar.*

I. Hyrje

Ndërmjetësimi familjar u krijua në SHBA në fund të viteve '60 dhe më pas bëhet i njohur në Europë për shkak të rritjes së ndarjeve dhe divorceve. Ndërmjetësimi familjar është një proces i cili ndihmon palët në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë të veçantë kur janë të përfshirë edhe fëmijët. Ndërmjetësimi ka si qëllim shuarjen e konfliktit, reduktimin e stresit dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës tek çiftet gjatë divorcit.

Sipas Buzzi dhe Haynes (1996), ndërmjetësimi familjar propozohet si një qasje alternative me qëllim menaxhimin e konfliktit tek çiftet gjatë divorcit ku një person i tretë neutral, ndërmjetësi, synon të lehtësojë mosmarrëveshjet ndërmjet palëve.

Sipas Lisa Parkinson (1997), ndërmjetësimi familjar është një metodë e cila i mundëson palët të menaxhojnë problemet e tyre në ndryshim nga procesi gjyqësor. E thënë ndryshe, ndërmjetësimi është një sistem alternativ i krijuar posaçërisht për të rregulluar mosmarrëveshjet ndërpersonale të çiftit dhe të sistemit familjar.

Zhvillimi i procesit të ndërmjetësimit në SHBA dhe Europë erdhi për shkak të rritjeve të rasteve civile në institucione të tilla si gjykata. Për këtë motiv, lindi nevoja e gjetjes së alternativave të reja në ndihmë të procesit gjyqësor, në mënyrë për t'i ofruar individëve një shërbim sa më efikas në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve familjare. Në këtë kontekst, ndërmjetësimi u kthye në një metodë efektive për të ndihmuar çiftet në krizë duke përfshirë kështu edhe fëmijët. Për shembull, një ndërmjetës ndihmon palët të identifikojnë apo të rinjohin interesat e tyre të përbashkëta dhe më pas të jenë të aftë të marrin vendime në lidhje me këto interesa.

Duhet theksuar se parimet bazë të ndërmjetësimit familjar, si parimi i konfidencialitetit, neutralitetit etj, janë shumë të rëndësishme pasi përcaktojnë identitetin distinktiv të këtij profesioni fisnik dhe përdoren nga të gjithë ndërmjetësit, pavarësisht llojit të ndërmjetësimit.

Disa ndërmjetës familjarë punojnë në kuadër të një modeli specifik ndërmjetësimi, ndërkohë që disa të tjerë përdorin metodën eklektike, pra, përzgjedhin elementë ose teknika të modeleve të ndryshme duke i integruar në një model të vetëm. Edhe pse të ndryshëm ndërmjet tyre, qëllimi i secilit model është të ndihmojë çiftin në krizë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, menaxhimin e stresit dhe rritjen e cilësisë së jetesës. Për shembull, konflikti mund të zgjidhet duke përdorur modelin global i cili përfshin aspektet ndërpersonale dhe ekonomike apo financiare, ose konflikti mund të zgjidhet duke përdorur modelin e integruar i cili i jep më shumë rëndësi çështjeve të trashëgimisë se sa çështjeve ndërpersonale dhe anasjelltas. Modelet e mëposhtme do të diskutohen në mënyrë më të detajuar në kapitullin e mëposhtëm.

II. Modelet e ndërmjetësimit familjar

2.1 Modeli Global i Ndërmjetësimit Familjar

Ndërmjetësimi familjar është propozuar si një qasje alternative në menaxhimin e konflikteve tek çiftet gjatë divorcit, ku një person i tretë, i paanshëm, i quajtur ndërmjetës, vepron që të lehtësojë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve. Disa ndërmjetës familjarë punojnë në kuadrin e një modeli specifik të ndërmjetësimit. Literatura botërore njih disa modele kryesore ndërmjetësimi, sikurse janë Modeli Struktural i E-it, Modeli Transformativ i Bush dhe Folger, Modeli Global i Haynes, Modeli Terapeutik i Irving dhe Modeli i Integruar ose Parcial i Emery-it.

Modeli Global u propozua nga psikologu John M. Haynes më 1978 në SH.B.A. dhe më pas në Kanada dhe Europë. Modeli Global përfshin një proces ndërmjetësimi të karakterit global, sepse struktura e tij është e organizuar në mënyrë të tillë që të përfshijë çdo problematikë të ardhur nga ndarja apo divorci, përfshirë këtu çështje të karakterit ndërpersonale si edhe çështje të trashëgimisë. Sipas Haynes (1996), mosmarrëveshjet ndërpersonale të sistemit familjar janë të pandashme nga çështjet financiare nga ku burojnë edhe konfliktet. Ndarja e tyre do të rezultonte në ndërprerjen e procesit të ndërmjetësimit.

Procesi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve fillon në momentin kur bashkëshortët pranojnë ekzistencën e një problemi tashmë të krijuar që në martesë, dhe për këtë ata i drejtohen shërbimeve të ndërmjetësimit (Corsi & Sirignano, 1999; 53). Gjatë kontaktit të parë në telefon, ndërmjetësi parashtron parimet bazë të procesit ndërmjetësimit. Nëse palët bien dakord me kushtet, atëherë fiksohet takimi i parë në të cilin të ndërmjetësimit. Ndërmjetësi informon kështu çiftin mbi procesin dhe numrin e seancave të ndërmjetësimit sqarohen pikat më të rëndësishme të procesit të ndërmjetësimit të analizuara më parë gjatë bisedës telefonike. Sipas ekspertëve ndërmjetës, seancat e para të ndërmjetësimit janë të rëndësishme për çiftin pasi bëjnë të qartë motivimin e palëve drejt zgjidhjes së konfliktit (Corsi & Sirignano, 1999).

Disa nga teknikat kryesore të modelit global janë brainstorming dhe teknika e zgjidhjes së problemeve. Kjo e fundit fokusohet në brendësinë e problemit, pra tek interesat e përbashkëta të palëve dhe jo tek pozicionet individuale. Nga ana tjetër, ndërmjetësi sugjeron teknikën e brainstorming për të parë sa lloje idesh, përfshirë edhe ndërmjetësin, janë në gjendje të propozojnë pjesëmarrësit, sado të çuditshme të jenë ato me qëllim krijimin e një atmosfere relaksuese e cila mund të ndihmojë në zhbllokimin e mënyrës së të menduarit (Haynes, 1996). Ndërmjetësi mbledh informacion lidhur me këndvështrimet e palëve, duke vënë në dukje aspekte të tilla në të cilat ata pajtohen dhe aspektet në të cilat ata kanë përplasje. Pas kalimit të kësaj faze, atëherë mund të procedohet me analizën e opsioneve.

Hapi tjetër përfshin arritjen e një negociate midis palëve, duke krijuar mundësinë e një zgjedhjeje të favorshme në interesin e të dy partnereve dhe me pas synimin e një marrëveshjeje përfundimtare. Natyrisht, kjo fazë e fundit është e arritshme vetëm

në qoftë se janë kaluar me sukses të gjitha hapat procedurale, në mënyrë që palët të mund të kenë një vizion më të sigurt për jetën.

Në fund, kur palët arrijnë një marrëveshje verbale, ndërmjetësi nëpërmjet saj formalizon një marrëdhënie, në të cilën përfshihen gjithë informacionet në lidhje me palët, dhe qëllimin e marrëveshjes. Ky dokument përfshin aspektet ekonomike, dhe marrëdhëniet ndërpersonale ndërmjet partnerëve dhe fëmijëve të tyre (Buzzi & Haynes, 1996).

2.2 Modeli Struktural ose Settlement-Directed Mediation (Coogler, Kaslow, Roberts-Fisher e Ury)

Modeli struktural është krijuar nga Coogler në mesin e viteve '70 dhe ka si qëllim arritjen e një ekuilibri në çështjet e pushtetit dhe kontrollit në çift. Hapësira e rezervuar për ndjenjat lidhur me mosmarrëveshjet, megjithatë, është shumë e vogël në krahasim me rëndësinë që i kushtohet aspekteve financiare të bashkëshortëve. Në këtë kuptim, mund të thuhet se ndërmjetësimi struktural shmanget trajtoje sferën emocionale duke u fokusuar kështu në qëndrimet e partnerëve bashkëpunues (L. Parkinson, 1997).

Modeli struktural përfshin një procedure specifike të ndërmjetësimit familjar e cila ndjek një rend logjik dhe historik duke u marrë me çështje të tilla si edukimi/arsimimi i fëmijëve, ndarja e të mirave materiale, kujdestaria e fëmijëve, kujdestaria e bashkëshortëve (Corsi & Sirignano, 1999; 51).

Coogler, në fakt, dizajnoi modelin e tij duke u nisur nga ky kriter baze, sepse në këtë mënyrë klientët të cilët do t'i drejtoheshin ndërmjetësimit familjar, do të donin të ndjeheshin të sigurt që në fillim të procesit se të gjitha çështjet e rëndësishme do të adresohen gjatë procesit të ndërmjetësimit duke synuar në arritjen e marrëveshjeve nga të dyja palët.

Në këtë mënyrë, klientët janë të ftuar të udhëhiqen nga ndërmjetësi me besim, që, me anë të rendit të vendosur lidhur me diskutimin e problemeve të përcaktojnë çështjet më kryesore për të nxitur me pas një diskutim produktiv. Gjithashtu, siç u përmend më parë, rregullat e propozuara nga ky model kanë tendencë të kufizojnë strategjitë konkurruese në çift, dhe të nxisin tek partneret qëndrime bashkëpunuese.

Për çdo temë që diskutohet gjatë procesit të ndërmjetësimit krijohen disa vështirësi, dhe në këtë aspekt, ajo që e dallon këtë lloj ndërmjetësimi nga të tjerët është mjeti i krijuar nga Coogler, e quajtur "skema e zgjidhjes së problemit". Bëhet fjalë për një skemë të detajuar me hapa e cila ndërmjetësi duhet të respektojë gjatë seancave të ndërmjetësimit (Ardone & Mazzoni, 1994). Kryesisht, kjo është e ndarë në katër faza.

Në fazën e parë, të dyja palët, me ndihmën e ndërmjetësit duhet të përcaktojnë qartë vështirësitë e tyre lidhur me problemin, dhe me pas duhet të analizohen një nga një pa i ngatërruar me njëri-tjetrin. Në fazën e dytë, pasi palët janë përballur me problemin, ndërmjetësi merr përsipër një rol më aktiv, i cili ka si funksion rikërkimin e informacionit lidhur me çështjet e ngritura nga secili partner. Në këtë fazë, ndërmjetësi përpiket te krijojë një raport besimi me ta. Në fazën e tretë, pas kalimit të vështirësive fillestare, palët vlerësojnë opsionet dhe të udhëhequr nga ndërmjetësi, kërkojnë një marrëveshje të përbashkët, dhe vlerësojnë të mirat dhe të këqijat e çdo alternative. Në fazën e katërt dhe të fundit, palët zgjedhin alternativën më të mirë në lidhje me problemin e diskutuar. E rëndësishme për t'u theksuar është fakti që gjatë fazës së katërt mund të dalin aspekte të reja të problemit, të cilat kërkojnë një rikthim të fazave të mëparshme. Pra, nëse palët nuk arrijnë në një marrëveshje, ndërmjetësi i këshillon palët t'ju rikthehen fazave të hershme, ose ai vendos të mbyllë procedurën e ndërmjetësimit.

Lidhur me ndërmjetësimin e strukturuar, numri i takimeve të nevojshme për të zgjidhur situatën në tërësi, nuk janë të specifikuar, megjithatë, në momentin që procesi i ndërmjetësimit duhet të zhvillohet brenda një kohë të kufizuar, numri maksimal i seancave nuk mund të kalojë 8-10 takime. Pasi palët arrijnë në një marrëveshje, ndërmjetësi shënon në listën e detajuar të gjitha vendimet e marra nga palët së bashku me motivacionet e tyre relevante.

2.3 Modeli i Integruar i Ndërmjetësimit Familjar (Emery, Marlow, Sauber e Bernardini)

Modeli i Integruar i ndërmjetësimit familjar u krijua gjatë viteve 80 nga Lenard Marlow dhe Richard Sauber. Ky model lindi në SHBA, por me pas u përhap kryesisht në Angli dhe Itali.

Modeli i integruar dallohet nga modelet tjera veçanërisht sepse ndërhyrja gjatë seancave të ndërmjetësimit kryhet nga dy profesionistë të ndryshëm, ndërmjetësin dhe avokatin. Këta të fundit punojnë në vende të ndryshme por në mënyrë të integruar.

Termi "i integruar" i referohet marrëdhënies mes ndërmjetësit dhe avokatit të cilët bashkëpunojnë në menaxhimin e konfliktit të çiftit. Ndërmjetësi e ka si detyrë të ndihmojë çiftin të shuajë konfliktin duke stimuluar komunikimin midis tyre. Ndërmjetësi ekspert ka aftësinë të ndihmojë palët edhe në negociimin lidhur me përgjegjësitë prindërore, për shembull, vendbanimi principal i fëmijëve si edhe mënyrat në të cilat prindërit marrin vendime lidhur me këta të fundit. Avokati, megjithatë, kujdeset për të negociuar në arritjen e marrëveshjeve lidhur me çështjet financiare (Giannella & Palumbo & Vigliar, 2007).

Në këtë model, ndërmjetësi ndihmon palët sipas një stili jo direktiv. Zakonisht i kushtohet rëndësi lënies së hapësirës për shprehjen e emocioneve lidhur me çdo aspekt praktik të riorganizimit të jetës familjare. Në këtë kuptim, procesi i ndërmjetësimit të integruar nuk është i ngurtë dhe nuk ka rregulla formale, por i lihet palëve të udhëheqin procesin. Ndërmjetësi i ndihmon palët që të përqendrohen tek e ardhmja lidhur me interesat e përbashkëta që ende ekzistojnë dhe ripërcaktimin e marrëdhënieve midis partnerëve.

2.4 Modeli Terapeutik (Irving e Benjamin)

Modeli terapeutik i Irving dhe Benjamin është krijuar me qëllim përshtatjen dhe menaxhimin e një game të gjerë marrëdhëniesh të pranishme tek çiftet. Sipas Irving e Benjamin, përpara zbatimit të një negocimi kërkohet që marrëdhëniet ndërpersonale mes palëve të arrijnë një ekuilibër.

Duke u nisur nga përvojat e Irving dhe Benjamin, proceset relacionale ishin pikërisht pika kryesore në të cilën çiftet bllokoheshin apo dështonin gjatë procesit të ndërmjetësimit. Si rezultat, shumë nga këto çifte mund të përfitonin nga një ndërhyrje paraprake, me qëllim modifikimin e sjelljeve disfunktionale si edhe bllokimin e përfshirjes apo ndikimit të njerëzve të tjerë, duke i dhënë kështu mundësinë për të marrë pjesë në negocim (Corsi & Sirignano, 1999).

Për këtë arsye, kjo qasje është përcaktuar si modeli terapeutik i ndërmjetësimit familjar, sepse i ve theksin komunikimit të hapur dhe kongruent të çifteve si edhe kontekstin e tyre social. Ky model ka si objektivi të përcaktojë pikën e takimit midis nevojave të çiftit dhe teknikave të ndërmjetësimit, në mënyrë që t'i ndihmojë ata të arrijnë një marrëveshje miqësore dhe mbi të gjitha të qëndrueshme. Në këtë kuptim, modeli terapeutik i referohet teknikave të terapisë sistemike-relacionale si edhe modeleve të komunikimit.

E rëndësishme është për t'u theksuar se pas ndarjes së bashkëshortëve, sistemet e familjare pësojnë ndryshime të thella strukturore përsa i përket marrëdhënies midis çiftit dhe bashkëveprimeve tejet emocionale me familjet e origjinës. Si rrjedhojë, mund të përfshihen në situatën e krijuar anëtarët e familjes, miqtë dhe avokatët.

Rrjedhimisht, përfshirja e personave të tjerë brenda modelit sistematik të çiftit, tashmë i paqëndrueshëm në vetvete, mund të shkaktojë ose arritjen e një ekuilibri të procesit të bashkëpunimit të çiftit ose krijimin e modeleve jofunkionale, të cilat zakonisht çojnë në situata konflikti të qëndrueshme. Përmes këtij modeli, çifti jo vetëm ndihmohet në arritjen e një marrëveshjeje, por gjithashtu motivohet edhe nga vetë ndërmjetësi me qëllim ndryshimin e modeleve të sjelljes, mendimeve dhe emocioneve.

Procesi i ndërhyrjes terapeutike të ndërmjetësimit familjar përfshin katër faza, të njohura veçanërisht për tre aspektet e tij të rëndësishme që e dallon atë nga modelet e tjera, nga ku përmendim procesin e vlerësimit, aplikimin selektiv të para-ndërmjetësimit, si edhe përsëritshmërinë e fazave të procesit.

Faza e parë është vlerësimi, i cili vlerëson disponueshmërinë e çiftit në hyrjen e procesit të ndërmjetësimit. Procesi i vlerësimit konsiston në mbledhjen e të dhënave, përfshirë këtu gjendjen psikologjike apo emocionale të çiftit, modelin e tyre të komunikimit, edukimin e fëmijëve, si dhe burimet e tyre financiare. Nëpërmjet mbledhjes së të dhënave mund të vërehen tre tipologji klientesh; kliente të papërshtatshëm, ata të cilët ndjehen menjëherë të gatshëm t'i hyjnë procesit të ndërmjetësimit, dhe ato që me siguri mund të jenë në gjendje të negociojnë, pasi e kanë kaluar me sukses fazën e para-ndërmjetësimit.

Kohëzgjatja e vlerësimit zhvillohet në tre sesione, një nga të cilët zhvillohet në mënyrë individuale me secilin bashkëshort dhe tjetri bashkërisht. Përzgjedhja e sesioneve individuale është krijuar me qëllim vendosjen e besimit dhe inkurajimin e elementit të sinqeritetit. Pas vlerësimit, nëse është e nevojshme, kalohet në fazën e para-ndërmjetësimit, ose drejtpërdrejt në atë të negocimit (Corsi & Sirignano, 1999).

Faza e para-ndërmjetësimit nënkupton ndërhyrjen terapeutike në të cilën bashkëshortët të cilët konsiderohen të përshtatshëm për ndërmjetësim, por, për arsye të marrëdhënies jo-funkionale brenda në çift, dështojnë të arrijnë në një marrëveshje të përbashkët. Qëllimi është rivendosja e një komunikimi të shëndetshëm midis partnereve dhe përcaktimi me saktësi i proceseve sistemike-relacionale të cilat mund të bllokojnë procesin e ndërmjetësimit. Përveç kësaj, kjo fazë mund të përsëritet nëse është e nevojshme gjatë procesit të negocimit, në rastin kur ndërmjetësi identifikon mënyra negative bashkëveprimi si edhe bllokimin e kanaleve të komunikimit dhe shprehjes së emocioneve të çiftit.

Në këtë pikë, çifti mund të hyjë në fazën e negocimit, në të cilën kërkohet arritja e një marrëveshjeje lidhur me pikat kryesore të çështjes në fjalë. Çështjet që diskutohen në lidhje me aspektet prindërore dhe ekonomike përcaktohen bashkërisht me ndërmjetësin.

Përcaktimi i problematikave të çështjeve realizohet përmes teknikës së zgjidhjes së problemeve, teknike kjo e përdorur edhe nga modelet e tjera të ndërmjetësimit, edhe pse në modelin terapeutik, theksi i vihet aspekteve emocionale të çiftit.

Më pas, ndërmjetësi përcakton rendin kronologjik të diskutimit të çështjeve, duke u nisur nga çështjet më të thjeshta për të zgjidhur, për të arritur më vonë tek ato më të vështira, me qëllim parapërgatitjen e çiftit ndaj një qëndrimi më pajtues dhe miqësor. Nëse në rrjedhën e negociatave krijohen veçanërisht momente të vështira midis bashkëshortëve, ndërmjetësi mund t'i ndihmojë ata duke i siguruar mbështetje emocionale, ose mund të vendosë të pezullojë përkohësisht seancën, në mënyrë që t'i japë mundësinë çiftit të rimarrë kontrollin mbi gjendjen emocionale. Në përfundim të procesit të negocimit, ndërmjetësi ndihmon çiftin të vendosë afatet dhe kushtet e një marrëveshjeje jo-formale.

Hapi i fundit përfshin procesin e follow-up-it që ka si objektivi të kontrollojë, gjashtë javë pas përfundimit të procesit të ndërmjetësimit, progresin e çiftit dhe gjithashtu të vlerësojë nëse marrëveshja e arritur mund të modifikohet apo jo. Nëse është e nevojshme, mund të linde nevoja e kthimit të fazës së para-ndërmjetësimit apo fazës së negocimit (Corsi & Sirignano, 1999).

2.5 Modeli Transformativ (Bush & Folger)

Modeli i transformativ i Bush dhe Folger e përkufizon ndërmjetësimin si “një proces në të cilin një palë e tretë ndihmon palët për të ripërcaktuar cilësinë e dinamikave të tyre ndërpersonale duke transformuar konfliktin nga negativ dhe destruktiv në pozitiv dhe konstruktiv përmes observimit dhe diskutimit të problematikave dhe zgjidhjeve të mundshme” (Bush, 1994).

Kjo qasje, i jep mundësinë palëve ta drejtojnë ata vete procesin e ndërmjetësimi, ndërkohë që ndërmjetësi i ndjek dhe i inkurajon drejt komunikimit pozitiv dhe dëgjimit empatik midis palëve. Ndërkohë që është krijuar mirëkuptim ndërmjet palëve duke e pare problemin e tyre nga një këndvështrim tjetër pozitiv, i gjithë kuadri mund të transformohet (L. Parkinson, 1997; 59). Megjithatë, ndërmjetësi parashtron metodat e ndërhyrjes te cilat kontribuojnë në arritjen e dy objektivave kryesore: fuqizimin (empowerment) dhe njohjen. Nga njëra ane, fuqizimi inkurajon vetëvendosje dhe autonomi, duke forcuar aftësinë e njerëzve për të parë në mënyrë të qartë gjendjen e tyre. Nga ana tjetër, njohja përfshin aftësinë për të njohur këndvështrimet dhe ndjenjat e personit tjetër.

Sipas Curie (2001), ndërmjetësimi transformativ ka si qëllim të nxisë riorganizimin e marrëdhënieve duke u fokusuar në ndërveprimin dhe komunikimin ndërmjet partnereve, e cila mund të çojë në një rritje morale. Pajtimi i konflikteve është një rezultat i kënaqshëm, por i një rëndësie dytësore. Fokusi kryesor tek marrëdhëniet nënkupton faktin se ndërmjetësi duhet t'i takojë palët në seanca të përbashkëta.

Konflikti mund të gjenerojë ndjenja vulnerabiliteti apo dobësie dhe egocentrizmi tek palët, në sensin që ndjeshmëria e njërit partner mund të forcojë partnerin tjetër duke e bërë në mënyrë të pashmangshme konfliktin të rritet me shume. Për të shmangur këtë, detyra e ndërmjetësit është të transformojë ndjenjën e dobësisë në forcë dhe egocentrizmin në aftësinë e identifikimit.

Ndryshe nga llojet e tjera të ndërhyrjes, ndërmjetësi transformues nuk menaxhon procesin, por e shoqëron dhe mbështet palët duke përdorur aftësinë e reflektimit, sintezës dhe verifikimit. Pra, ndërhyrjet direktive se si të zbatosh një program, të theksosh arsyet e përbashkëta dhe të kërkosh origjinën e problemeve, mbeten për t'u evituar.

Mbështetësit e ndërmjetësimi transformativ besojnë se kjo qasje i ofron palëve një mundësi për të transformuar

konfliktin nga negativ në pozitiv, duke i vene theksin dinamikave të marrëdhënieve konstruktive (L. Parkinson, 1997).

III. Konkluzione

Ndërmjetësimi familjar është një proces i cili lehtëson menaxhimin e konfliktit dhe stresit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tek çiftet gjatë divorcit. Krijimi i disa grupeve të studimit mbi ndërmjetësimin familjar ka sjellë kontributin e vet të ideve dhe përvojës. Përveç kësaj, profesionistët, përfshirë avokatë, gjyqtarë, psikologë, punonjës socialë, me aftësitë e tyre të ndryshme kanë kontribuar për një efikasitet më të madh në qendrat e ndërmjetësimi. Këta faktorë kanë ndikuar në krijimin dhe zhvillimin e disa modeleve kryesore të cilat mund të kontribuojnë me efikasitet në procesin e ndërmjetësimi në vendin tonë në përshtatje me kulturën lidhur me fenomenin e divorcit. Edhe pse të ndryshëm ndërmjet tyre, qëllimi i secilit model është të ndihmojë çiftin në krizë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në menaxhimin e stresit dhe në rritjen e cilësisë së jetesës. Literatura botërore njih disa modele kryesore ndërmjetësimi, sikurse janë Modeli Struktural i Coogler-it, Modeli Transformativ i Bush dhe Folger, Modeli Global i Haynes, Modeli Terapeutik i Irving dhe Modeli i Integruar ose Parcial i Emery-it. Secili nga këto modele tregon rrugën e vet të procesit të ndërmjetësimi, duke dhënë qasje të ndryshme drejt procesit të pajtimit të çifteve, por, natyrisht, jo të gjitha modelet mund të jenë të suksesshme për t'u zbatuar në vendin tone, pasi kjo varet jo vetëm nga konteksti i kulturës të çdo vendi, por edhe nga tipologjia e çifteve të cilët vendosin të ndërmarrin rrugën e procesit të ndërmjetësimi familjar.

Studime të ndryshme tregojnë se nuk ka ende një preferencë të veçantë përse a përket modeleve të ndërmjetësimi pasi kjo varet nga kontekste të ndryshme sociale, kulturore, familjare, përfshirë edhe tiparet karakteriale në të cilën ndodhen çiftet.

Megjithatë, edhe pse modelet e ndërmjetësimi familjar nxjerrin në pah elemente të përbashkët, është e udhës të evidentohen qasjet e ndryshme që paraqesin këto modele drejt zgjidhjes së konflikteve dhe mosmarrëveshjeve në çift.

Për shembull, modeli terapeutik i Irving, parashikon në mënyrë të thelluar për çiftin fazën e para-ndërmjetësimi gjatë seancave, në kontrast me modelin struktural dhe global të Coogler dhe Haynes. Këto dy të fundit marrin në konsideratë faktin se në momentin që çifti është gati të ndërmjetësojë, e rëndësishme është trajtimi i teknikave të negociimit. Meqenëse ndërmjetësimi i bazuar në një marrëveshje direkte të modelit struktural mbështetet në tekniken e negociimit të arsyetuar, theksi në këtë model i vihet arritjes së rezultateve konkrete dhe zgjidhjeve në nivelin praktik. Në këtë kuptim, ekziston risku që ndërmjetësit e modelit struktural të synojnë arritjen e një rezultati të shpejtë dhe zgjidhjen imediate të konfliktit pa i kushtuar kohen e duhur aspektit emocional.

Nga ana tjetër, modeli terapeutik ve në dukje se ekzistojnë çifte të cilët nuk janë ende gati për të bashkëpunuar në zgjidhjen e konflikteve në procesin e ndërmjetësimi. Në këtë sens, këto tipologji çiftesh mund të jenë të aftë të hyjnë në procesin e ndërmjetësimi vetëm nëse i ofrohet një ndihme paraprake në seanca individuale dhe i kushtohet rëndësia e duhur aspektit emocional. Megjithatë, mbetet e rëndësishme të theksohet se kjo nuk do të thotë se modelet e tjera të ndërmjetësimi nuk i kushtojnë vëmendje proceseve ndërpersonale të çiftit, por ato thjesht nuk maksimizojnë rëndësinë e aspekteve emocionale duke i kushtuar një vëmendje më të vogël.

Një tjetër diferencë mund të shihet në lidhje me prezencën apo jo të fëmijëve në takimet e ndërmjetësimi familjar. Në modelin struktural, prindërit apo çifti inkurajohen të sjellin fëmijët e tyre në seancat e ndërmjetësimi. Ndërsa në modelin terapeutik, fëmijët nuk marrin pjesë në këto seanca, vetëm nëse prindërit konsultohen me parë me eksperte psikologe, mund të marrin në konsideratë përfshirjen e fëmijëve.

Megjithatë, dallimi kryesor midis modelit terapeutik dhe modelit transformativ, është fokusi i tij mbi vlerësimin paraprak të ndërmjetësimi terapeutik. Për më tepër, ndryshe nga llojet e tjera të modeleve të ndërmjetësimi familjar, ndërmjetësi

transformativ nuk e menaxhon procesin, por shoqëron dhe mbështet palë të reflektojnë për në zgjidhje alternative ne interesin e tyre.

Në kontrast me modelet e tjera ku trajtohet një temë të vetme, siç janë fëmijët ose çështjet financiare, ndërmjetësimi global, për shembull, merret me të gjitha çështjet e përfshira në ndarje ose divorc, duke u nisur qe nga kujdestaria e fëmijëve, përkrahja dhe mirëmbajtja e tyre, çështjet e pronës etj. Nga ana tjetër, ndërmjetësimi i integruar merr parasysh vetëm disa aspekte në procesin e ndarjes ose divorcit. Në këtë kuptim, në ndërmjetësimin e integruar adresohen vetëm çështjet që lidhen me kujdestarinë e fëmijëve sipas një stili jo direktiv.

Me një vështrim të shpejtë të kësaj panorame, mund të konkludohet se për sa kohë modelet e ndërmjetësimit janë të ndryshme nga njëri-tjetri, qëllimi i përbashkët i çdo modeli mbetet riorganizimi i marrëdhënieve familjare, pas ndarjes apo divorcit. Sigurisht, kjo behet e mundur përmes rihapjes se kanaleve të komunikimit të palëve. Dhe ky është pikërisht parimi i ndërmjetësimit: Mbështetja dhe aksesin ndaj nevojave të sistemit familjar, rëndësia e komunikimit të hapur dhe kongruent në mbajtjen e një sistemi të shëndetshëm familjar me qëllim rritjen e aftësive prindërore dhe rivendosjen e klimës së komunikimit dhe bashkëpunimit.

Bibliografia

- ARDONE R., MAZZONI S., *La mediazione familiare*, Giuffrè, Milano, 1994;
CIGOLI V., *Psicologia della separazione e del divorzio*, il Mulino, Bologna, 1998;
CORSI M., SIRIGNANO C., *La mediazione familiare. Problemi, prospettive, esperienze*, Vita e Pensiero Editore, Milano, 1999;
COSI G., FODDAI M. A., *Lo spazio della mediazione*, Giuffrè, Milano, 2003;
DI LAURO D., *La comunicazione strategica: il modello sistemico relazionale*, Xenia Edizioni e Servizi, Milano, 2010;
GIANNELLA E., PALUMBO M., VIGLIAR G., *Mediazione familiare e affido condiviso*, Sovera, Roma, 2007;
MARZOTTO C., TELLESCHI R., *Comporre il conflitto genitoriale. La mediazione: metodo e tecniche*, UNICOPOLI, Milano, 1999;
MOTRONI A., *Consultori familiari e mediazione*, in COSI G., M. A., FODDAI (a cura di), *Lo spazio della mediazione*, Giuffrè, Milano, 2003;
PARKINSON L., *La mediazione familiare: modelli e strategie operative*, Erikson, Londra, 1997;
PARKINSON L., *L'esperienza inglese dei servizi di Mediazione Familiare*, in SCABINI E., ROSSI G., (a cura di), *Rigenerare i legami: la mediazione nelle relazioni familiari e comunitarie*, Vita e Pensiero Editore, Milano, 2003;
SCABINI E., *Psicologia sociale della famiglia*, Bollati e Boringhieri, Torino, 1985;

PARAJA ELEKTRONIKE DHE PËRDORIMI I SAJ NË SHQIPËRI

MSC. KESTRINA RAMALLARI

Universiteti European i Tiranës

ABSTRAKT

Paraja elektronike është një ndër instrumentet më të përdorura sot. Paraja cash duket sikur po zëvendësohet çdo ditë e më shumë nga paraja elektronike. Ndonëse një instrument shumë i përdorur në tregun botëror, në Shqipëri përdorimi i parasë elektronike nuk ka të njëjtin nivel përdorimi. Më gjithë përpjekjet e bëra, mungesa e teknologjisë, infrastrukturës së përshtatshme apo dhe e faktorëve të tjerë, kanë patur një ndikim negativ në zhvillimin e parasë elektronike në vendin tonë. Nëpërmjet këtij punimi synohet të vihen në dukje faktorët të cilët ndikojnë ose jo në përdorimin e parasë elektronike, në Shqipëri. Përdorimi i kësaj të fundit, mbetet ende në nivele të ulta, në krahasim me përdorimin e parasë elektronike në vendet e tjera.

Analizat e bëra për të arritur rezultatet janë ato përshkruese, vrojtuese si dhe analiza krahasuese e bërë me Maqedoninë. Synimi i këtyre analizave është të nxjerrë në pah arsyet se pse konsumatorët në Shqipëri preferojnë të përdorin paranë cash apo paranë elektronike.

Studimi arrin në konkluzionin që në Shqipëri, niveli i përdorimit të parasë elektronike është në nivele modeste. Kjo për shkak të mungesës së kulturës financiare, kostove që ka përdorimi i parasë elektronike, dhe shumë faktorëve të tjerë. Rekomandimet që qeveria, bankat, si dhe institucionet e tjera të interesuara japin, janë të integrohet kultura financiare që në shkolla, të ulen kostot, konsumatorët të jenë të siguar nga sulmet e ndryshme që bëhen gjatë transaksioneve elektronike

Fjalë kyç: *para elektronike, para cash, kulturë financiare, institucione financiare*

Hyrje

Për vërtetimin e hipotezës së mësipërme, do të bëhet një analizë mbi përdorimin e parasë elektronike në Shqipëri. Analiza e kryer do të jetë një analizë përshkruese e kombinuar me një analizë vrojtuese. Ky punim përdor të dhëna parësore dhe dytësore. Të dhënat parësore janë marrë nga një anketim i kryer në popullsi, dhe synon të nxjerrë të dhëna të cilat nuk gjenden në një formë të përmbledhur. Anketimi do të jetë pjesë e analizës vrojtuese, dhe do të përbëhet nga disa pyetje thelbësore, nëpërmjet të cilave synohet të zbulohet niveli i përdorimit të parasë elektronike në vendin tonë. Kampionimi i përzgjedhur do të jetë sa më i përafërt me popullatën e marrë në studim, për të parë impaktin që paraja elektronike ka në vendin tonë, kush e përdor më shumë, a kanë problem me përdorimin e saj apo jo, dhe më e rëndësishmja a i besojnë kësaj teknologjie e cila është relativisht e re për tregun tonë bankar. Të gjitha këto pyetje do të jenë të rëndësishme për të përcaktuar se si perceptohet e ardhmja e parasë elektronike në Shqipëri.

Nisur nga kjo formë, modeli që do të përdoret në këtë temë diplome, do të jetë ai deduktiv nëpërmjet së cilit duke synohet një konkluzion mbi përdorimin e parasë elektronike, nisur nga parimet e përgjithshme.

Të dhënat e përdorura në këtë temë do të jenë faktike dhe vlerësuese. Gjithashtu ato do të jenë të dhëna parësore, të cilat do të merren nëpërmjet pyetësorit dhe të dhëna të tjera dytësore, të cilat do të merren nga paper-a të ndryshëm, site zyrtare shqiptare dhe të huaja, libra, revista shkencore, konferenca, internet, etj. Kriteret kryesore mbi të cilat ky punim bazohet për të mbledhur informacionet janë tre: vlefshmëria - të jenë sa më afër realitetit; besueshmëria - të jenë burime të besueshme; dhe bazueshmëria - të jenë burime transparente dhe koherente.

Si metodë për hartimin e kësaj teme do të përdoret metoda sasiore por edhe metoda cilësore. Miksimi i të dy metodave do të shërbejë për të parë teorikisht se si është zhvilluar sistemi i parasë elektronike në botë, dhe sa përdoret ai sot, duke e krahasuar më pas edhe me sistemin e pagesave elektronike në Shqipëri. Për shmangien e një temë plotësisht teorike, por edhe për të qenë më konkrete në rezultatet e nxjerra, do të vihen në përdorim edhe të dhëna statistikore. Mbledhja e të dhënave do të jetë e tillë që të dhënat të jenë të krahasueshme dhe të analizohen. Rezultatet e marra do të paraqiten jo vetëm nëpërmjet shifrave dhe përqindjeve por edhe nëpërmjet tabelave dhe grafikëve të ndryshëm. Kjo me qëllim që në fund rezultatet të jenë sa më të qarta dhe të kuptueshme.

Në fund të punimit, synohet të arrihen disa konkluzione në bazë të analizës së bërë. Më pas, bazuar po në këtë analizë, do të jepen disa rekomandime të cilat mendohet se janë të nevojshme për të ardhmen dhe zhvillimet që sjell përdorimi i parasë elektronike.

Koncepte të përgjithshme mbi paranë

Paraja është mjete kryesor në tregun ekonomik. Ajo ka katër funksione kryesore: matës i vlerës, mjet akumulimi, mjet shkëmbimi dhe mjet pagese. Shpeshherë del në pah dhe një funksion i pestë, ai i parasë botërore, një funksion i cili shfaqet në tregtinë ndërkombëtare (Milton, Schwart, 2009). Paraja ka kaluar në shumë etapa. Zhvillimi i qytetërimit u shoqërua dhe me zhvillimin e parasë në formë dhe jo vetëm. Vlera e saj ka ndryshuar shumë. Vitet e fundit, me zhvillimin e teknologjisë, ka filluar të përdoret dhe paraja elektronike. E lehtë në përdorim, e dobishme, e sigurt dhe mjaft komode, paraja elektronike duket se po përdoret gjithnjë e më shumë në mbarë botën. E krijuar për të qenë një mënyrë pagese e thjeshtë për përdoruesin por që kërkon një nivel të caktuar të zhvillimit të teknologjisë bankare, paraja elektronike mund të shihet si një “konkurrente – armike” e parasë tradicionale. Përkundrazi, ajo është vetëm një mundësi më shumë për të kryer më lehtësisht pagesa apo për të transferuar para (BSH 2007)

Paraja elektronike po përdoret gjithnjë e më shumë në ditët e sotme duke treguar një potencial gjithnjë e më të madh për sa i përket sistemit të pagesave. Ajo nuk është shumë ndryshe nga gjithë llojet e tjera të parasë që kanë ekzistuar deri më sot. Ajo është një fenomen që po zhvillohet gjithnjë e më shumë së fundmi, dhe komponentët e tij teknikë, ekonomikë, juridikë dhe kulturorë nuk janë zhvilluar ende plotësisht. Përpjekjet janë të shumta, por megjithatë ende ka dyshime nëse do të jetë plotësisht i pranueshëm në treg apo jo. Shifrat zyrtare kanë treguar se totali i parasë elektronike në qarkullim në bankat europiane në fund të vitit 2007 ka qenë rreth 450 milion (Rees 2007). Në veçanti ajo është lënë pas dore për sa i përket dispozitave ligjore në shumë vende. Shumica e vendeve europiane deri vonë e kanë patur të vështirë të kuptonin mënyrën dhe llojin e teknologjisë së përdorur, përveç vendeve si Anglia dhe Austria të cilat kanë qenë ndër vendet e para që e kanë adaptuar këtë sistem.


Në krahasim me atë që ne quajmë *cash*, e cila përdor vetëm karakteristikat e sigurisë fizike, produktet elektronike përdorin kriptografitë për të vërtetuar transaksionet dhe për të mbrojtur fshehtësinë dhe integritetin e të dhënave. Paraja elektronike nuk ka nevojë të shkëmbehet fizikisht, siç ndodh me monedhat dhe kartëmonedhat, duke lehtësuar kështu pagesat e largëta. Në një raport të Bankës Europiane tregohen ngjashmëritë, në aspektin ekonomik, midis depozitave pa afat, dhe kartave me parapagesë. Duhet theksuar që, për transferat në shuma të vogla, përdoret paraja elektronike, pasi ofrohet me kosto më të ulët. Ndërsa kur bëhet fjalë për shuma të mëdha, pagesat bëhen nëpërmjet bankës, pasi risku i përdorimit të parasë elektronike, është i konsiderueshëm (European Central Bank 2008).

Paraja elektronike dhe llojet e saj

Përkufizimi që Banka Qendrore Europiane i ka bërë parasë elektronike është cilësuar si njëndërpërkufizimet më të sakta (European Central Bank 2010). Ajo thotë: ‘Paraja elektronike njihet gjerësisht si një rezervë elektronike e vlerës monetare në një pajisje teknike, e cila mund të përdoret gjerësisht për të bërë pagesa të ndryshme pa qenë e nevojshme përfshirja e bankës’. Ajo citohet si një

shembull i “portofolit elektronik”, në të cilën përdoruesit mund të depozitojnë shuma jo shumë të mëdha parash në një smart card, dhe t’i përdorin ato para për të kryer pagesa të ndryshme. Këto pagesa mund të bëhen edhe nëpërmjet aparateve celularë (BIS 2007) apo kryerja e pagesave nëpërmjet llogarive online me bazë internetin. Transaksionet e parasë mund të ndahen në dy kategori: ato që kërkojnë përdorimin e parasë cash, dhe ato që nuk e kërkojnë. Transaksionet jo-cash, nga ana tjetër, janë dy tipe: letër dhe në mënyrë elektronike. Më poshtë jepet një skemë e transaksioneve cash dhe jo-cash (Sardoni, Verde, 2002).

SKEMA 1 TRANSAKSIONET CASH DHE TRANSAKSIONET JO - CASH



Burimi: Sardoni C., Verde A. "The IT revolution and monetary system: Electronic Money and its effects", 2002

Pagesat nëpërmjet parasë jo cash me bazë letër mund të bëhen ose nëpërmjet çek-ut bankar, ose nëpërmjet letrave të transfertave. Në të dy rastet, individët duhet të paraqiten në bankë fizikisht, në mënyrë që të dorëzojnë çekun apo letrat e transfertave për të kryer pagesat apo për të tërhequr paratë. Ndërkohë që për pagesat jo-cash në mënyrë elektronike, paraqitja në bankë nuk është e domosdoshme.

Edhe vetë paraja elektronike ndahet në 2 kategori të tjera:

Paraja elektronike e cila funksionon nëpërmjet kartave të parapaguara (karta që blihen nga përdoruesit)

Paraja elektronike e cila nëpërmjet disa lloje softwear-ash lejon që shitësit dhe blerësit të kalojnë fondet nëpërmjet rrjetit elektronik.

Paraja elektronike mund të jetë e identifikueshme dhe e paidentifikueshme (anonime) (CBI 20013)¹. Paraja elektronike e identifikueshme përmban informacion mbi identitetin e personit, i cili ka tërhequr paratë nga banka. Paraja e identifikueshme i jep mundësi bankës “të gjurmojë” paranë, teksa qarkullon nëpër ekonomi. Për shembull, kur paguani diçka duke përdorur një kartë krediti, banka është në gjendje të identifikojë pagesën e kryer dhe në këtë mënyrë, mund të reduktojë shumën e paguar nga llogaria juaj bankare.

Paraja elektronike anonime funksionon njësoj si paraja cash. Në momentin që paraja elektronike anonime tërhiqet nga banka nëpërmjet një llogarie bankare, ajo shndërrohet në para cash (para prej letrave) dhe mund të shpenzohet pa lënë asnjë gjurmë të transaksionit të kryer. Identiteti i personit i cili bën pagesën nuk bëhet i ditur.

Paraja Elektronike dhe karakteristikat e saj

Studiuesit kanë bërë disa propozime për sa i përket karakteristikave kryesore që duhet të ketë paraja elektronike. Megjithatë më kryesorët sipas ekspertëve, paraja elektronike duhet të jetë e siguruar, anonime, portabël, pa patur nevojën e palëve të treta, fleksibël (Marimon, Nicolini, 2007)², etj.

Karakteristika e parë dhe më e rëndësishme është siguria që duhet të ofrojë paraja elektronike dhe besimi që klientët duhet të kenë tek ajo. Infrastruktura e parasë elektronike duhet të sigurojë përdoruesit e saj nga risku i krimeve kibernetike. Sistemi i parasë elektronike duhet të jetë shumë i fuqishëm, i pathyeshëm, dhe të jetë i tillë gjatë gjithë kohës në mënyrë që të ofrojë siguri vazhdimisht. Njerëzit përgjithësisht i mundohen të tolerojnë problemet që mund t’iu ndodhin bankave për shkak të ndonjë problem në sistem, por ata do të mërzhiteshin shumë nëse nuk do të mund të kishin akses në paratë e tyre elektronike (European Commission, 2013)³.

Anonimati është një tjetër karakteristikë shumë e rëndësishme. Kjo është një mënyrë për të ruajtur privatësinë e klientit.

Nuk është e nevojshme që blerësi dhe shitësi të kenë të dhëna për njëri-tjetrin. Çdo lloj transaksioni duhet të jetë private,

¹ Central Bank of Ireland, “Guidance Note on completing an Application for Authorisation as an Electronic Money Institution”, Qershor 2013

² Marimon R., Nicolini J.P., Teles P., *Electronic Money: The End of Inflation?*, gusht 2007

³ ‘E - money’. *The EU Single Market*. European Commission. 11 gusht 2013

për secilën palë. Paraja cash është plotësisht anonime, pra duke bërë transaksionin në cash, asnjëri prej palëve nuk merr informacion për palën tjetër. Të njëjtën siguri duhet të ofrojë edhe paraja elektronike, megjithëse kjo është pak e vështirë, pasi të gjithë të dhënat e përdoruesve të parasë elektronike janë të ruajtura në një databazë. Megjithatë, këta përdorues duhet të jenë të sigurt që të dhënat e tyre nuk do të bëhen publike për asnjë arsye.

Paraja elektronike duhet të jetë portabël, që do të thotë, e pavarur nga një vend fizik. Ajo duhet të jetë e aksesueshme kudo ku ka rrjet për të përdorur paranë elektronike, nëpërmjet kartave të ndryshme smart. Paraja elektronike duhet të jetë e transferueshme dhe e shpërndarë në rrjete dhe paisje të ndryshme.

Për të kryer një pagesë nëpërmjet parasë elektronike, nuk duhet të jetë e nevojshme ndërhyrja e një pale të tretë. Ajo duhet të funksionojë si paraja cash, e cila kalohet direkt nga paguesi tek marrësi, në çdo kohë, dhe në çdo vend pa patur nevojë për miratimin e bankës apo të ndonjë institucioni tjetër të autorizuar.

Por paraja cash ka disa kufizime për sa i përket prerjeve të monedhave. Paraja elektronike nuk duhet ta ketë këtë kufizim. Ajo duhet të përdoret herë pas here duke krijuar fleksibilitet tek përdoruesit e saj (FCA, 2013)⁴.

Paraja elektronike duhet të jetë e pranueshme gjerësisht nga konsumatorët. Ajo duhet të jetë e thjeshtë në përdorim, pa qenë e nevojshme që njerëzit të mësojnë procedura shtesë përdoruesit duhet të vendosin vetë të ndryshojnë shumën minimale apo maksimale të pagesave të tyre, të kenë akses në monitorimin e pagesave që ata bëjnë. Kosto e parasë elektronike nuk duhet që jetë e lartë aq sa konsumatorët të mos e përballojnë dot (NPSD 2009)⁵. Gjithashtu sistemi i parasë elektronike, duhet të ketë mundësi të përmirësohet dhe të azhurnohet thjeshtë.

Avantazhet dhe Disavantazhet e përdorimit të Parasë Elektronike

Ashtu si çdo shërbim tjetër edhe paraja elektronike ka disa avantazhe dhe disavantazhe të cilat janë ndikues në përdorimin ose jo të saj. Më poshtë do të radhiten anët pozitive dhe negative të përdorimit të parasë elektronike.

Avantazhet

Disa nga avantazhet që ofron përdorimi i parasë elektronike mund të radhiten si më poshtë⁶:

Zgjedhje e re për konsumatorët (2010)⁷ - një nga avantazhet më të mëdha të parasë elektronike është se kjo lloj pagese është shumë e përshtatshme për pagesat në shuma të vogla. Është më e thjeshtë dhe më e shpejtë sesa të tërheqësh para nga llogaria dhe më pas të bësh pagesat, ose të plotësosh një çek bankar të cilin do të duhet ta mbash kudo me vete. Për të gjithë pagesat në shuma jo shumë të mëdha, duke përfshirë dhe ato pagesat që bëhen nëpërmjet internetit, të bësh një pagesë modeste për çdo blerje, është më e përshtatshme dhe me kosto më të ulët sesa të përdorësh paranë cash.

Lehtësira në përdorim - të përdorësh kartat e debitit apo të kreditit nuk është kërkon njohjen e shumë procedurave, të cilat jo rrallë herë janë të ngatërrueshëm. Kryerja e pagesave elektronike është e thjeshtë për çdo individ të shoqërisë.

Nuk duhet të presësh në radhë - një nga problemet kryesore që hasim nëpër markete apo dyqane, është pritja në radhë për të kryer pagesën, dhe për të marrë kusurin që të takon. Nëpërmjet parasë elektronike kjo nuk është më e nevojshme, pasi siç u përmend dhe më sipër, transfertat bëhen elektronikisht, brenda një kohë shumë të shkurtër, prej disa sekondave.

Nuk është e nevojshme të mbash para cash kudo – asnjëherë nuk e di sesa para të duhen për të shpenzuar në një ditë. Mund të ndodhë që të nevojiten para për të kryer një pagesë, por fatkeqësisht bankat janë të mbyllura dhe bankomat afër nuk ka. Në këtë rast do të duhet të kryesh pagesën në një moment tjetër, kur të kesh paratë e mjaftueshme. Por nëse pagesa kryhet nëpërmjet kartave elektronike, nuk është e nevojshme që të kesh para cash me vete, pasi debitimi ndodh direkt nga llogaria bankare, pa patur nevojën e tërheqjes së tyre nga ndonjë ATM.

Paraja elektronike nuk mund të dëmtohet - në ndryshim nga paraja cash, ajo nuk mund të griset, të laget apo të vjetërsohet me kalimin e kohës.

Kosto më e ulët – transferimi i parave në mënyrë elektronike është më pak e kushtueshme po të krahasohet me pagesat nëpërmjet çeqeve. Sipas 'National Automated Clearing House Association' të kushton 10 herë më shumë po të kryesh pagesat nëpërmjet çekut, sesa në mënyrë elektronike. Më parë kur bankat i jepnin blloqet e çeqeve falas, kostot nuk ishin shuma të larta, dhe përdorimi i çekut në vend të parasë cash, ishte komod për një pjesë të mirë të shoqërisë. Ndërsa sot klientët duhet të paguajnë ekstra për të marrë një bllok çeku, dhe kjo ka bërë që kjo lloj pagese të përdoret gjithnjë e më pak (ASC, 2011)⁸.

Je në dijeni të pagesave që kryen – nëse përdoret më shumë paraja cash, është e vështirë të dish saktësisht se ku i ke shpenzuar paratë, dhe sa para ke harxhuar për secilin produkt të blerë apo shërbim të konsumuar. Por nëse përdoret

⁴ Financial Conduct Authority, "The FCA's role under the Electronic Money Regulations 2011. Our Approach", qershor 2013

National Payment System Department, "Position Paper on Electronic Money", nentor 2009

Federal Reserve of Chicago, 'Electronic Money', 2010

US Department of the Treasury Conference, An Introduction to Electronic Money Issues

Ayments System Council, Central Bank of Trinidad & Tobago, "The role of banks relative to non-banks in electronic money operations", shtator 2011

paraja elektronike, mjafton që të shkosh në bankë dhe të kërkosh një nxjerrje të llogarisë tënde, dhe aty do të shohësh me detaje se kur i ke kryer shpenzimet dhe për çfarë arsye janë bërë ato. Kështu je gjithë kohës në dijeni të shpenzimeve mujore që kryen.

Me krijimin e parasë elektronike shumë banka kanë nxjerrë produkte të ndryshme në treg, nëpërmjet të cilave të gjithë kanë mundësi të transferojnë fonde nga një llogari bankare në tjetrën, të blejnë artikuj të ndryshëm në internet, të paguajnë faturat e ujit, të dritave, të telefonit etj.

Disavantazhet

Nisur nga ato që u thanë më sipër, duhet të shtohet se paraja elektronike ka dhe disa disavantazhe, të cilat jo në pak raste frenojnë njerëzit në përdorimin e saj.

Një nga problemet kryesore, është teknologjia (2008)⁹. Ndonëse në pamje të parë teknologjia duket si një bekim për njerëzimin, ajo shpeshherë ka patur një ndikim negativ gjatë transfertave të parave elektronike. Vjedhja e fjalëkalimeve, hyrja në llogari të dikujt pa patur leje, përdorimi i parave të tjerëve nëpërmjet pagesave online, kanë bërë që shumë njerëz të bëhen mosbesues në përdorimin e parasë elektronike. Fakti që paraja elektronike është e padukshme në sytë e njerëzve, në ndryshim nga cash-i i cili shihet në momentin e kryerjes apo marrjes së pagesës, njerëzit kanë tendencën të kenë një lloj pasigurie për këtë lloj pagese.

Efektet makroekonomike si ndryshimi i kursit të këmbimit mund të ndikojnë gjatë përdorimit të parasë elektronike (Arnone, Bandiera, 2004)¹⁰. Mund të ndodhë që konsumatorët të paguajnë më shumë, për shkak të rritjes të kursit të këmbimit, që merret automatikisht nga banka tek e cila konsumatori ka llogarinë personale. Ky është një tjetër faktor i cili ndikon negativisht në përdorimin e parasë elektronike.

Një tjetër problem që haset gjatë përdorimit të parasë elektronike, është dhe ulja e likuiditetit të parasë cash¹¹. Duke përdorur shumë parane elektronike, nuk mund të ketë qarkullim të mjaftueshëm të parasë në treg, gjë e cila çon në uljen e likuiditetit në tregun e brendshëm financiar.

Paraja elektronike dhe përdorimi i saj në tregun shqiptar

Historia e parasë elektronike në Shqipëri fillon në vitin 2003, me hapjen e një numri të vogël të ATM-ve (sporteleve automatike). Sot, një pjesë e mirë e bankave që operojnë në Shqipëri kanë krijuar një rrjet të zgjeruar ATM-sh në Tiranë dhe në disa qytete të tjera. Vitet e fundit është rritur numri i përdoruesve të ATM-ve, nga 34,090 në rreth 295,250 (BSH, 2007)¹². Kjo, ka ardhur si rezultat i kalimit të pagës së buxhetorëve nëpërmjet rrugëve bankare. Megjithatë hezitimin nga një pjesë e nëpunësve të administratës publike, tashmë të gjithë punonjësit e kësaj administrate paguhet nëpërmjet llogarive, në bankat e nivelit të dytë. Si rrjedhojë, tërheqja e pagave nëpërmjet këtyre llogarive është kthyer në një veprim shumë të zakonshëm. Rritja e numrit të përdoruesve të parasë elektronike në Shqipëri ka qenë paralele me rritjen e transaksioneve në rrugë bankare. Kështu, është vënë re një rritje e madhe për sa i përket kartave të kreditit, të cilat nga 806 që ishin në vitin 2004 janë shtuar në 4,245. Për sa i përket kartave të debitit dhe atyre cash, ato janë shtuar respektivisht nga 6,552 në 70,176 dhe nga 26,736 në vitin 2004, në 220,657 në vitin 2006¹³.

Pagesat elektronike në tregun Shqiptar janë një term i njohur, e megjithatë numri i transaksioneve mbetet ende shumë i ulët. Sipas raporteve të fundit të Bankës Botërore për studimin e bërë mbi “Sistemin e Pagesave në gjithë Botën”, Shqipëria rankohet në pjesën e fundit të nivelit të mesëm të sistemit të pagesave elektronike, në të njëjtin grup me Sudanin (World Bank 2008)¹⁴.

Në Shqipëri, sipas raporteve të Bankës së Shqipërisë (BSH, 2014)¹⁵, instrumenti kryesor nëpërmjet të cilit bëhen pagesat, është paraja cash. Gjatë vitit 2012, vetëm 2.5% e të gjitha pagesave janë kryer në mënyrë elektronike, e cila në mënyrë të qartë tregon se pagesat elektronike janë ende në nivelet më të ulëta krahasuar me BE, ku pagesat elektronike përbëjnë më shumë se 50% të totalit transfertat.

Sipas raporteve të marra, instrumenti i pagesave që përdoret më shumë është paraja cash. Më poshtë pasqyrohen dhe produktet e-banking që janë aprovuar nga Banka e Shqipërisë në vitet 2006 – 2012 (BSH, 2012)¹⁶.

Në tregun shqiptar, ekziston një numër i madh bankash të cilat ofrojnë këto produkte bankare. Produktet të cilat këto banka ofrojnë më së shumti janë ATM-të dhe kartat e kreditit. Në tabelën 2 jepen disa të dhëna të marra nga Banka e Shqipërisë mbi bankat e nivelit të dytë të cilat ofrojnë produktet e-banking më të përdorura në tregun bankar në vendin

Queensland Law Society, “*Electronic Funds Transfer, guidelines for trust accounting operations*”, shkurt 2008

Arnone M., Bandiera L., “*Monetary Policy, Monetary Areas and Financial Development with Electronic Money*”, korrik 2004

Griffith R., Austin S.F., “*Electronic Money and Monetary Policy*”

Banka e Shqipërisë, “*Paraja elektronike: E ardhmja e parasë?*”, 2007

IBID

World Bank, “*Payment Systems Worldwide, A snapshot. Outcomes of the Global Payment System Survey 2008*”, 2008

Banka e Shqipërisë, “*Raportet mbi Sistemin e Pagesave*”, 2014

Banka e Shqipërisë, *Supervision Annual Report 2012*

TABELA 1 PRODUKTET E-BANKING TË APROVUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË PËR VITET 2006 – 2012

Produktet Elektronike	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Total
Karta e Debiti	6	4	2	2	-	-	-	14
Karta e Krediti	5	3	1	1	1	-	-	11
Karta Maestro (Kredit)	1	-	1	1	-	-	-	3
Karta Master (Debit)	-	-	1	2	-	-	-	3
Karta Visa (Debit)	-	-	-	1	-	-	-	1
Karta Visa (Kredit)	-	-	-	1	-	-	-	1
Multicash	1	-	-	-	-	-	-	1
ATM -të	6	4	2	2	-	-	-	14
POS	1	2	2	1	-	-	-	6
Internet banking	2	2	3	2	2	-	-	11
Phone banking	-	-	1	-	-	-	-	1
Mobile banking / SMS banking	-	-	1	1	1	1	1	5
Kartat e parapaguara	-	-	-	-	-	1	-	1

Burimi : Banka e Shqipërisë

tonë. Aty shihet qartë se shumica e bankave ofrojnë ATM-të, Internet – banking si dhe kartat elektronike (kartat e debitit dhe kartat e kreditit). Kjo tregon qartë shumëllojshmërinë e bankave nëpërmjet të cilave konsumatorët mund të zgjedhin të përdorin këto produkte elektronike bankare. Ndërsa Shoqata Shqiptare e Bankave¹⁷ raporton të dhëna për çdo muaj, midis të cilave mund të gjenden të dhëna dhe mbi instrumentet bankar. Këto të dhëna vijnë në ndihmë për të kuptuar ecurinë që kanë patur produktet bankare, disa prej të cilave janë përmendur dhe në tabelën e mësipërme, gjatë viteve. Vitet e marra në shqyrtim në tabelën 3 janë për muajt mars të çdo viti, nga viti 2008 deri në vitin 2014.

TABELA 2 PRODUKTET E-BANKING MË TË PËRDORURA NË TREGUN BANKAR NË VENDIN TONË.

Bankat	ATM	POS	Internet Banking	Phone Banking	Mobile /SMS Banking	Karta Elektronike (debit,kredit)
Raiffeisen Bank	✓	✓	✓		✓	✓
BKT	✓	✓	✓		✓	✓
Tirana Bank	✓		✓	✓	✓	✓
NBG	✓					✓
Alpha Bank	✓	✓	✓			✓
ProCredit Bank	✓	✓	✓			✓
FIB	✓		✓			✓
Banka Credins	✓	✓	✓			✓
Union Bank	✓		✓		✓	✓
Societe Generale Bank	✓		✓			✓
Intesa SanPaolo Bank	✓	✓	✓			✓
Veneto Bank	✓		✓			✓
ICB	✓					✓
Credit Agricole	✓					✓

Burimi : Banka e Shqipërisë

Shoqata Shqiptare e Bankave, *Buletinet Mujore të Sistemit Bankar (të dhëna të paaudituar)*, 2014

TABELA 3 PËRDORIMI I INSTRUMENTEVE BANKARË GJATË VITEVE 2008 - 2014

Emertimi	Mars-08	Mars-09	Mars-10	Mars-11	Mars-12	Mars-13	Mars-14
Karta Krediti	638.606	503.662	558.494	680.465	697.489	723.477	741.128
Karta Debiti	14.564	17.302	24.494	28.635	40.329	53.93	64.432
Nr. ATM	470	685	792	778	796	817	822
Nr. POS	2.138	3.196	4.593	4.835	5.08	5.266	5.668
Nr. Trans. me karta (mujore)	989.357	751.492	865.871	964.054	1.065.465	1.024.846	1.156.913
Volumi trans.me karta (mil ALL, mujore)	6.961	8.126	9.267	9.579	10.405	10.61	11.186
Nr.Trans.Online (mujore)					18.118	21.596	31.707
Volumi trans. Online (mil ALL, mujore)					9.58	6.865	6.225

Burimi : Banka e Shqipërisë

Nga tabela e mësipërme vihet re se me kalimin e viteve ka patur një zhvillim të instrumentave dhe produkteve bankare. Shihet qartë që ka patur një rritje të numrit të kartave të kreditit dhe kartave të debitit. Pothuajse është dyfishuar numri i ATM-ve dhe vihet re një rritje akoma më e madhe e POS-ve në vend. Numri i transaksioneve me karta brenda një muaji në mars të vitit 2008 shënonte një shifër prej 989.357 transaksione, ndërkohë që në të njëjtën periudhë kohore, 6 vite më vonë, numri i transaksioneve me karta shënon një shifër prej 1.156.913 transaksione në muaj. Duke u bazuar dhe në të dhënat zyrtare mbi popullsinë¹⁸, 26% ka arritur përqindja e përdorimit të kartave elektronike në total në mars të vitit 2014, ndërkohë që në po të njëjtën periudhë në mars të vitit 2008, përqindja e përdorimit të kartave elektronike nga ana popullore shënonte një vlerë prej 21%. Rritje të tillë ka patur dhe volume i transaksioneve me karta në milionë lekë, i cili ishte 6.961 milion lekë në mars të vitit 2008 dhe ka arritur shifrën e 11.186 milionë lekë në mars të vitit 2014.

Nisur nga të dhënat zyrtare, dhe duke synuar në nxjerrjen e disa të dhënave të tjera të cilat vijnë në ndihmë të temës, është zhvilluar një pyetësor mbi paranë elektronike.

Pyetësori përmban gjithsej 15 pyetje. Hartimi i pyetjeve është bërë me qëllim arritjen e një konkluzioni për njohuritë rreth parasë elektronike dhe se sa e përdoret ajo në vendin tonë. Anketimi është realizuar në Tiranë. Kjo për arsye se është dhe vendi me popullsi më të madhe në Shqipëri. Kampionimi u bë sa më gjithëpërfshirës në moshë dhe gjini. Mënyra e realizimit të anketës ishte 2 lloje: e para ishte shpërndarja e pyetësorit nëpërmjet rrjeteve elektronike dhe sociale, dhe mënyra e dytë ishte ajo tradicionale “ballë për ballë me anketuesin”.

Për sa i përket shpërndarjes së parë, nëpërmjet rrjeteve sociale, edhe në këtë rast është bërë një përzgjedhje e personave të cilëve i janë dërguar këto pyetësorë. Jam munduar që të ketë një shpërndarje në moshë dhe gjini. Gjithsej janë dërguar 120 anketa online, por 97 ka qenë numri i atyre të cilët i janë përgjigjur. Ndërsa për sa i përket pyetësorëve të krye në mënyrë tradicionale, në total u shpërndanë 60 pyetësorë por vetëm 54 prej tyre u përgjigjën. Gjatë procesimit të të dhënave, 1 nga pyetësorët doli i pavlefshëm. Kështu në total, nga 180 anketa të shpërndara, u arrit të merreshin 150 anketa të vlefshme.

Pyetjet janë të gjitha pyetje të mbyllura, ku për secilën pyetje janë dhënë dy ose tre alternativa, në varësi të pyetjes. Në anketë nuk ka asnjë pyetje të hapur, ku të anketuarit të mund të përgjigjeshin sipas mendimit të tyre. Është zgjedhur rasti i anketës me pyetje të mbyllura, për disa arsye. Në radhë të parë për të marrë përgjigje sa më koncize, dhe pa patur probleme atë që të anketuarit mund të shkruanin. Një tjetër arsye është dhe për shkak se kur lihen pyetje të hapura, ndodh se për shkak të kohës, apo dhe për shkaqe të tjera, probabiliteti për t'i lënë këto pyetje pa plotësuar është i madh. Duke iu dhënë alternativa, ia u lehtëson më shumë punën të intervistuarve, dhe në fund kur mblidhen rezultatet, e ke më të lehtë të procesosh të dhënat e anketës.

Analiza vrojtuese dhe të dhënat e marra prej saj

Për të arritur në të dhëna sa më të sakta, gjatë studimit është bërë dhe një pyetësor për të parë se sa njihet paraja elektronike në Shqipëri dhe sa përdorim gjen ajo në tregun vendas. Pas marrjes së rezultateve arrihet në disa të dhëna si:

Shumica e të anketuarve ishin me arsim të lartë (58.9%)

Individët të cilët përdorin më shumë paranë elektronike janë ata të moshës 18-30 vjeç (52.4%), dhe më pak nga individët e moshës mbi 40 vjeç (16%)

Të gjithë të intervistuarit janë shprehur se e përdorin më shumë paranë elektronike sepse mendojnë se është një ide e zgjuar dhe komode në përdorim


Më të predispozuar për të kryer pagesa nëpërmjet aparatit celular ishin individët e moshës 18-30 vjeç (80%), dhe më pak të predispozuar ishin ata të moshës mbi 40 vjeç (52%)

Teknologjia është e pranuar më gjerësisht në moshat e reja. Sa më shumë të rritet moshja e individëve, aq më të vështirë e kanë ata të përshtaten me teknologjitë e reja që qarkullojnë në treg. Prandaj dhe përdorimi i pagesave nëpërmjet aparateve celularë është më i madh tek moshat e reja, dhe vjen duke u ulur me rritjen e moshës së përdoruesve. Lidhja që ekziston midis tyre, është një lidhje e zhdrejtë.

Kjo gjë u vu re dhe në pyetjen se a do ishin të gatshëm të zëvendësonin paratë cash me paratë elektronike, ku vetëm kategoria e parë 18-30 vjeçe u përgjigjën pozitivisht (85%) ndërsa ata më skeptikët ishin individët e moshës mbi 40 vjeç (25%)

Nga të dhënat u vu re se sa më i lartë të ishte arsimi i të anketuarve aq më shumë ata e përdornin paratë elektronike.


GRAFIKU 1 ARSIMI DHE NDIKIMI I TIJ NË PËRDORIMIN E PARASË ELEKTRONIKE



Burimi: të dhënat e mbledhura nga autorja

Arsimi është ndikues gjithashtu edhe në besueshmërinë që individët kanë përkundrejt pagesave elektronike. Nga kombinimi i të dhënave mbi besueshmërinë dhe arsimimin e të anketuarve, vihet re se individët më të arsimuar, rreth 83% prej tyre, janë shprehur se iu besojnë pagesave elektronike, pjesa e cila nuk është besuese e këtyre pagesave përbën vetëm 1 % të të anketuarve, ndërsa 16% e të anketuarve janë shprehur se nuk kanë një opinion të qartë. Kjo kategori ndiqet nga personat me arsim bachelor, dhe në fund radhiten personat të cilët kanë një arsim më të ulët. Edhe kjo lidhet me njohuritë që gjithsecili ka për paratë elektronike. Kultura financiare është më e lartë tek ata individë të cilët kanë një arsim më të madh sesa tek ata të cilët kanë një arsim më të ulët. Kjo duket dhe në vështirësinë që këta individë ndiejnë gjatë përdorimit të parasë elektronike. Ata të cilët anë më shumë vështirësi në pagesat elektronike janë individët të cilët kanë nivelin më të ulët arsimor. 37.5% e tyre janë shprehur se sistemi i pagesave elektronike iu duket i vështirë, ndërsa 62.5% kanë pranuar se ky sistem nuk iu duket i vështirë. Më pas kategoria e dytë, që është shprehur se ndien vështirësi, është ajo kategori ku përfshihen ata individë të cilët kanë mbaruar të paktën 3 vite të universitetit. 28.3 % dhe 71.7% kanë qenë të ndarë ata të cilët pranonin se ndjenin vështirësi në pagesat elektronike në krahasim me ata të cilët nuk mendonin se pagesat elektronike janë të vështira. Dhe së fundmi, ata të cilët duket se kanë më pak vështirësi në përdorimin e sistemit të pagesave elektronike, janë ajo kategori individësh, të cilët kanë mbaruar të paktën 5 vite universitet, ose që kanë një arsim më të lartë. 22.4% dhe 77.6% është ndarja midis atyre të cilët kanë vështirësi në përdorimin e pagesave elektronike dhe atyre të cilët nuk kanë vështirësi në këtë lloj pagese.

GRAFIKU 2 ARSIMI DHE VËSHTIRËSIA NË PËRDORIMIN E PARASË ELEKTRONIKE




Burimi: të dhënat e mbledhura nga autorja

Në përgjithësi, si ata të cilët kanë një nivel të ulët arsimor, edhe ata të cilët kanë një nivel të lartë arsimor, nuk mendojnë se përdorimi i pagesave elektronike është shumë i vështirë. Sigurisht që arsimit luan një rol të rëndësishëm në përgjigjen që ata kanë dhënë, por që diferencat nuk duken shumë të thella.

Arsimi duket se ndikon edhe në pritshmëritë e individëve për të ardhmen e parasë elektronike. 50% e të anketuarve janë të bindur se pas 5 vitesh paraja elektronike do të zëvendësojë parën cash.

Një tjetër faktor që përmendet në anketim janë dhe të ardhurat mujore të individëve. Rezultatet e anketimit tregojnë se individët të cilët përdorin më shumë parën elektronike janë ata me të ardhura mesatare mujore 50000-70000 all.

GRAFIKU 3 PËRDORIMI I PARASË ELEKTRONIKE NË RAPORT ME PARANË CASH SIPAS TË ARDHURAVE MESATARE MUJORE TEK INDIVIDËT



Burimi: të dhënat e mbledhura nga autorja

Nga të dhënat e mësipërme vihet re se tek të tre kategoritë, dominon përdorimi i parasë cash. Përdorimi i parasë elektronike është më i ulët, megjithatë edhe kjo ndryshon në varësi të të ardhurave të konsumatorëve. Konsumatorët që kanë një përdorim pak më të lartë të parasë elektronike, me 40%, janë ata konsumatorë për të cilët të ardhurat e tyre mesatare mujore variojnë në vlerat e 50'001 – 70'000 lekë. Pas tyre me një diferencë jo shumë të madhe, radhiten individët me të ardhura mesatare mujore 20'000 – 50'000 lekë, dhe ata të cilët e përdorin shumë pak parën elektronike në raport me parën cash janë personat me të ardhura mbi 70'000 lekë. Kjo ndoshta ka të bëjë dhe me sigurinë që këta persona kanë rreth parasë elektronike. Në analizat e mësipërme vihet re që personat të cilët kishin të ardhura mujore mbi 70'000 lekë, ishin ata persona të cilët kishin një moshë mbi 40 vjeç. Gjithashtu kjo kategori, ishte dhe kategoria e cila ishte më pak besuese për përdorimin e parasë elektronike. Mosnjohja mirë e teknologjive më të reja, i bën individët e kësaj kategorie edhe më mosbesues përdorimin e parasë elektronike. Të gjithë faktorët e mësipërm, të mbledhur së bashku, të drejtojnë rreth konkluzionit se individët të cilët kanë të ardhura mujore mesatare mbi 70'000 lekë, janë ata të cilët përdorin më pak parën elektronike dhe janë përdorues më të mëdhenj të parasë cash.

Të ardhurat janë një faktor ndikues edhe se si janë pritshmëritë për të ardhmen e parasë elektronike. Analiza e mëposhtme synon të nxjerrë në dukje se si personat me të ardhura të ndryshme mujore, mendojnë nëse paraja cash do të zëvendësohet nga paraja elektronike apo jo. Nga të dhënat e mbledhura vihet re se individët me të ardhura mesatare mujore 50'001 – 70'000 lekë janë ata individë të cilët kanë më shumë besim (rreth 60.7% prej të anketuarve), se paraja elektronike do të zëvendësojë parën cash. Vetëm 5.9% e të anketuarve janë shprehur se nuk besojnë se paraja elektronike do të zëvendësojë parën cash, dhe rreth 33.4% nuk janë në gjendje të japin një përgjigje të saktë rreth kësaj pyetje.

Të dytët në radhë, janë ata individë të cilët kanë të ardhura mesatare mujore të cilat variojnë në vlerat 20'000 – 50'000 lekë. 49.2% e tyre janë të bindur se paraja elektronike do të zëvendësojë parën cash, 12.6% nuk janë të bindur se paraja cash do të zëvendësohet nga paraja elektronike dhe një përqindje jo e vogël prej 38.2% ende nuk e dinë nëse paraja elektronike do të zëvendësojë parën cash.

Ndërsa të tretët në radhë janë ata individë të cilët kanë të ardhura mesatare mujore mbi 70'000 lekë. Tek këta individë shumica e të anketuarve, rreth 49%, janë përgjigjur se nuk kanë një përgjigje të qartë rreth kësaj pyetje. Më pas 44.4% janë përgjigjur se paraja elektronike do të mund të zëvendësojë parën cash, dhe vetëm 16.6% prej të anketuarve nuk janë të bindur se paraja cash do të zëvendësohet nga paraja elektronike. Nga të dhënat e mësipërme arrihet në konkluzionin se ata individë të cilët besojnë më shumë se paraja elektronike do të zëvendësojë parën cash, janë ata individë për të cilët të ardhurat e tyre mesatare mujore variojnë në vlerat e 50'001 – 70'000 lekë, të ndjekur më pas nga individët të cilët kanë të ardhura mesatare mujore 20'000 – 50'000 lekë, dhe të fundit radhiten individët me të ardhura mesatare mujore mbi 70'000 lekë. Këto të dhëna janë indikatorë nëpërmjet të cilave, bankat e nivelit të dytë, dhe institucionet e tjera të interesuara, mund të nxjerrin përfundime se cila është shtesa e individëve tek të cilët duhet të fokusohen për të nxjerrur përdorimin e parasë elektronike.


Të anketuarit e mësipërm kanë edhe disa parashikime për sa i përket kohës që duhet të kalojë që paraja elektronike të zëvendësohet nga paraja cash. Këto faktorë janë një kombinim tjetër nëpërmjet secilit synohet të parashikohet se sa kohë duhet të kalojë që paraja elektronike të jetë dominuese në përdorim në raport me parën cash sipas këtyre individëve, të cilët kanë të ardhura të ndryshme mujore.

Sipas kategorisë së parë, me të ardhura mesatare mujore të cilat variojnë në vlerat 20'000 – 50.000 lekë, shumica e të anketuarve, 52.3% janë shprehur se pas së elektronike do t'i duhen 5 vite që të zëvendësojë paranë cash. Më pas vijnë individët të cilët janë pak skeptikë. 35% e të anketuarve mendojnë se duhet të kalojnë të paktën 10 vite që paraja elektronike të përdoret më shumë se paraja cash. Ndërsa ata që nuk besojnë se ky zëvendësim do të ndodhë në një të ardhme të shpjëtë, dhe se do të duhen më shumë se 10 vite që paraja cash të zëvendësohet nga paraja elektronike përbëjnë 12.7% të të anketuarve. Nga kjo kategori vihet re se shumica e të anketuarve janë të mendimit se pas 5 vitesh do të mund të përdoret më shumë paraja elektronike se sa paraja cash.

Kategoria e dytë, e cila përbëhet nga individë me të ardhura mesatare mujore të cilat variojnë në vlerat 50'001 – 70'000 lekë kanë pothuajse të njëjtën mendim me kategorinë e parë. Më shumë se gjysma e të anketuarve, më saktësisht 60.8% prej tyre, mendojnë se do të duhen 5 vite që para cash të ketë një përdorim të vogël, dhe të përdoret më shumë paraja elektronike. 21.5% e të anketuarve shprehen se do të duhen të paktën 10 vite që të ndodhë ky zëvendësim. Ndërsa ata të cilët janë më pesimistët, 17.7% e të anketuarve, shprehen se do të duhen më shumë se 10 vite që njerëzit të përdorin më shumë paranë elektronike dhe më pak paranë cash.

Kategoria e tretë dhe e fundit, është ajo ku përfshihen individët me të ardhura mesatare mujore mbi 70'000 lekë. Tek këta individë, në ndryshim nga dy kategoritë e para, është ulur besimi se do të duhen vetëm 5 vite që paraja cash të zëvendësojë paranë elektronike. 38.8% e të anketuarve e mendojnë këtë gjë. Pjesa më e madhe, 41.6% (më pak se gjysma), janë të mendimit se do të duhen të paktën 10 vite që paraja elektronike të ketë një përdorim më të gjerë, në krahasim me paranë cash. Dhe 19.6% e këtyre të anketuarve, mendojnë se do të duhen më shumë se 10 vite që ky zëvendësim të ndodhë. Nga këto të dhëna shihet se individët e kësaj kategorie, duket se janë më pak optimist për sa i përket kohës që do të duhet që paraja cash të zëvendësohet nga paraja elektronike. Në ndryshim nga dy kategoritë e para, ku vihej re një dominim i individëve të cilët mendonin se do duhej vetëm 5 vite që të ndodhë një zëvendësim i tillë, sipas personave të cilët kanë të ardhura mesatare mujore mbi 70'000 lekë, do të duhen të paktën 10 vite që paraja elektronike të zëvendësojë paranë cash.

GRAFIKU 4 TË ARDHURAT E INDIVIDËVE DHE PRITSHMËRITË PËR TË ARDHMEN E PARASË ELEKTRONIKE



Burimi: të dhënat e mbledhura nga autorja

Të dhënat e mësipërme tregojnë, se edhe të ardhurat mund të vijnë në ndihmë të parashikimeve, për sa i përket afateve kohore, për një përdorim më të madh të parasë elektronike. Mbeten dominuese, dy kategoritë e para, të cilat janë më optimiste për të ardhmen e parasë elektronike, ndërkohë që kategoria e tretë, është pak skeptike, por që gjithsesi edhe kjo kategori shprehet se pas 10 vitesh përdorimi i parasë elektronike do mund të jetë më i madh se sa përdorimi i parasë cash.

Përfundime dhe Rekomandime

Përfundime

Pas studimit të hollësishëm të bërë mbi paranë elektronike, si nga ana cilësore ashtu dhe nga ana sasiore, mund të thuhet se hipoteza e shtruar në këtë studim u vërtetua plotësisht. Nga studimi i mësipërm mund të nxirren disa konkluzione.

Konsumatorët e njohin si term paranë elektronike, dhe disa kanë njohuri shumë të mira të funksionimit të saj, por pjesa më e madhe përdor ende paranë cash. Nga të dhënat kuptohet se do të duhet të kalojë një kohë e mirë deri sa paraja elektronike të bëhet jo vetëm një mënyrë pagese e zakonshme por të jetë në kulturën e çdo individi.

Faktori më i rëndësishëm janë të ardhurat. Pas studimit të bërë vihet re një tendencë më e madhe e përdorimit të parasë elektronike tek ata individë të cilët kanë të ardhura mesatare mujore që variojnë në shifrat 50'001 – 70'000 lekë. Kjo është dhe kategoria e cila preferon të përdorte më shumë paranë elektronike se sa paranë cash. Gjithashtu individët me këto të ardhura ishin dhe më optimist për sa i përket të ardhmes së parasë elektronike. Ata, përveç se shpreheshin të gatshëm të zëvendësonin përdorimin e parasë cash me paranë elektronike, gjithashtu shpreheshin që ky zëvendësim do të ndodhë shumë shpejtë, brenda 5 vitesh.

Një tjetër faktor që ndikon është dhe niveli arsimor i konsumatorëve. Individët me nivel më të lartë arsimor, janë dhe përdoruesit më të mëdhenj të parasë elektronike. Individët me arsim më të lartë ishin dhe ata të cilët shpreheshin më optimist për të ardhmen. Ata ishin të gatshëm të zëvendësonin përdorimin e parasë cash me paranë elektronike dhe shpreheshin se ky zëvendësim do të ndodhë pas 5 vitesh.

Mosha gjithashtu është një faktor ndikues në përdorimin ose jo të parasë elektronike. Vihej re një përdorim më i madh i parasë elektronike tek individët e moshës 18 – 30 vjeç. Ndërsa ata të cilët e përdornin më pak paranë elektronike ishin individët e moshës mbi 40– vjeç.

Rekomandime

Pavarësisht të gjithave, besohet se në të ardhmen jo shumë të largët, paraja elektronike do të jetë mënyra më e përhapur për kryerjen e pagesave. Për të përshpejtuar këtë trend, duhet të ndërmerren disa masa dhe të zbatohen disa rregulla.

Kërkohej një vëmendje më e madhe nga ana e qeverisë, bankave si dhe institucioneve të tjera të interesuara. Informimi mbi paranë elektronike dhe mënyrat e përdorimit të saj, duhet të fillojë që në bankat shkollore, në mënyrë që në të ardhmen individët të jenë më të informuar mbi paranë elektronike. Kjo do të ketë një ndikim pozitiv rritjen e përdorimit të parasë elektronike.

Sigurimi i individëve nga sulmet kibernetike.. Për të patur sa më pak “viktima” të sulmeve në rrjete elektronike, është e nevojshme instalimi i rrjeteve siguruese dhe surveimi i vazhdueshëm i klientëve të cilët përdorin paranë elektronike, gjithashtu është e nevojshme ndërmarrja e masave për dëm shpërblimin e individëve të cilët mund të bien pre e këtyre sulmeve. Vetëm kështu mund të ruhet besimi i konsumatorëve të cilët përdorin paranë elektronike, dhe në të njëjtën kohë të rritet dhe numri i përdoruesve të saj.

Rekomandohet që bankat të ulin kostot që individët duhet të paguajnë, për çdo transaksion të bërë. Ky reduktim i kostove mund të vijë dhe nëpërmjet kombinimit midis produkteve të ndryshme elektronike, gjë e cila do të çonte në uljen kostove si dhe në rritjen e përdorimit të parasë elektronike.

Bibliografia

- Arnone M., Bandiera L., “*Monetary Policy, Monetary Areas and Financial Development with Electronic Money*”, korrik 2004 Ayments System Council, Central Bank of Trinidad & Tobago, “*The role of banks relative to non-banks in electronic money operations*”, shtator 2011
- Bamodu G., “*The Regulation of Electronic Money Institutions in the United Kingdom*”, 2003 (2) *The Journal of Information, Law and Technology (JILT)*.
- Bank for International Settlements, “Survey of developments in electronic money and internet and mobile payments”, mars 2007 Banka e Shqipërisë, “Paraja elektronike : E ardhmja e parase?”, http://www.bankofalbania.org/web/Paraja_elektronike_Eardhmja_e_parase_3202_1.php
- Banka e Shqipërisë, *Supervision Annual Report 2012*, http://www.google.al/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=1&ved=0CBoQFjAA&url=http%3A%2F%2Fwww.bankofalbania.org%2Fpreviewdoc.php%3Fcrd%3D6603%26ln%3D2%26uni%3D20130729164122137510888272007200&ei=k4ylU5fdFcTYooGwDQ&usq=AFQjCNFpUBpyh1glGfTkJlam57yC_XICA&bvm=bv.69411363,d.bGE&cad=rja
- “*Basic Principles and Future of Electronic Money*”, www.justice.gov.tr/e-journal/pdf/basic_principles.pdf
- Canadian Foundation fo Economic Education, “Money: a historical view”, <http://www.moneyandyouth.cfee.org/en/resources/pdf/moneyhist.pdf>
- Central Bank of Ireland, Guidance Note on ompleting an Application for Authorisatio as an Electronic Money Institution, Qershor 2013
- European Commission “*E - money. The EU Single Market*”, 11 gusht 2013
- Ely B., “*Electronic Money and Monetary Policy : Separating Fact from Fiction, Alexandria*”, Virginia, <http://ely-co.com/media/Default/Articles/cato-596.pdf>
- European Central Bank, “*Report on Electronic Money*” 2008
- European Central Bank, “*The Payment System*”, 2010
- Federal Reserve of Chicago, ‘*Electronic Money*’, 2010 www.frbchi.org
- Financial Conduct Authority, “*The FCA’s role under the Electronic Money Regulations 2011. Our Approach*”, qershor 2013 Financial Services Authority, ‘*The Regulation of Electronic Money Issuers*’, Consulation paper 117
- Griffith R., Austin S.F., “*Electronic Money and Monetary Policy*”
- Grivoyannis E.C., “*Electronic Money In The Evolution Of Our Payments Mechansim*”, Yeshiva College
- HM treasury, “*Laying of regulations to implement the new W-Money Directive, a consulation document*”, October 2010

- Hove L.V, "Electronic money and the network externalities theory: lessons for real life", 2007
- Instat, *Paga Mesatare Mujore 2000-2013*, <http://www.instat.gov.al/al/themes/pagat-dhe-kosto-e-pun%C3%ABs.aspx?tab=tabs-5>
- Joint Money Laundering Steering Group, "Electronic Money", prill 2012
- Mantel.B, Federal Reserve Bank of Chicago, Policy Studies "Why don't Consumers Use Electronic Banking Products? Toward a Theory of Obstacles, Incentives, and Opportunities", September 2000
- Marimon R., Nicolini J.P., Teles P., "Electronic Money: The End of Inflation?", gusht 2007
- Milton F., Schwartz A.J., "Monetary Statistics of the United States: Estimates, Sources, Methods". 2009 NBER
- National Bank of the Republic of Macedonia, "Reports for Payment Operations, Cards and Devices", <http://www.nbrm.mk/defaulten.asp?ItemID=A50CBD0DD4755147989D7F3CE587B59>
- National Payment System Department, "Position Paper on Electronic Money", nentor 2009
- OECD, "The Future of Money", 2002
- Clarck A.O, "E-money Review", prill 2008
- Queensland Law Society, "Electronic Funds Transfer, guidelines for trust accounting operations", shkurt 2008
- Rees P., "E-Money Regulation: All Change", C.T.L.R. 2007
- Sardoni C., Verde A. "The IT revolution and monetary system : Electronic Money and its effects", 2002
- Shoqata Shqiptare e Bankave, "Buletinet Mujore të Sistemit Bankar (të dhëna të paditura)", 2014, <http://www.aab.al/al/statistics.php>
- Stalder F., "Electronic Money: Preparing the Stage, Faculty of Information Studies", University of Toronto
- "SWIFT Company Information", mars 2010, http://www.swift.com/about_swift/company_information/company_information?rdct=t&lang=en
- US Department of the Treasury Conference, "An Introduction to Electronic Money Issues"
- USAID, eGov Project, "ANALYSIS ON THE e-COMMERCE SITUATION IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA" November, 2010
- World Bank, "Payment Systems Worldwide, A snapshot. Outcomes of the Global Payment System Survey 2008", 2008, www.nclnet.org/shoppingonline/shoppingsurvey.htm
- www.digicash.com/
- www.theswiftcodes.com/albania/

DINAMIKA E DISKURISIT POLITIK TË LIDERIT SHQIPTAR

ORNELA ELEZI

Universiteti Europian i Tiranës

ABSTRAKT

Objekti i këtij studimi është diskursi politik. Por çfarë është saktësisht diskursi politik? Diskursi politik përcaktohet dhe identifikohet nga aktorët apo autorët e tij, politikanët. Pjesa më e madhe e studimeve mbi diskursin politik flet për të shkruarit e të folurit politikanëve dhe të institucioneve politike, si presidenti, kryeministri, të tjerë anëtarë të kabinetit qeveritar, parlamenti apo partitë politike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Politikanët në këtë kuptim janë grupe individësh që paguhen për aktivitetet e tyre politike, të cilët përzgjidhen apo emërohen (apo vetë emërohen) për të qenë në qendër të lojës politike. Kjo mënyrë e të përcaktuarit të diskursit politik është rrënjësisht e ndryshme nga ajo e të përcaktuarit të diskursit mjekësor apo ligjor me aktorët respektivë pjesëmarrës.

Ky studim e analizon diskursin politik nga një perspektivë socio-politike dhe e komunikimit. Në qendër të analizës janë marrëdhëniet mes diskursit politike, vlerave dhe sjelljes së liderit politik, vlerave dhe normave të shoqërisë politike, dhe sjelljes dhe qëndrimeve të individit dhe shoqërisë. Studimi zgjedh të analizojë diskursin politik në kontekstin e këtyre marrëdhënieve për tre arsye bazë:

Së pari, për shkak të besimit se ndonëse diskursi politik ka lidhje dhe mund të influencohet nga shumë faktorë të natyrës gjuhësore, psikologjike, ligjore, ekonomike, etj...

Së dyti, për shkak të besimit se vlerat dhe sjellja e liderit politik reflektojnë edhe marrëdhënien që ekziston midis shoqërisë politike dhe individit e shoqërisë në përgjithësi.

Së treti, për shkak të besimit se si diskursi i liderit politik, ashtu edhe vlerat dhe normat e shoqërisë politike reflektojnë në esencën dhe bazën e vet vlerat dhe qëndrimet e individit dhe të shoqërisë.

Fjalë kyç: *Diskurs; Lider; Politikë; Shqiptar; Teori*

Hyrje

Në opinionin e sotëm publik është krijuar një botëkuptim se shqiptarët nuk kanë pasur traditë të lirisë në politikë, respektivisht traditë të bazuar te një rend politik ku ka frymuar liria politike, ekonomike, kulturore e kështu me radhë. Ky argument ka shërbyer edhe si premisë për të ngritur argumente dhe konceptime të reja, madje edhe teori (siç është ajo e të “pa filozofuarës” e dr. Hysamedin Ferajt), të cilat aludojnë në ndryshime revolucionare në rregullimin e jetës politike dhe kulturore shqiptare.

Këto teori në parim janë pretencioze. Ato tentojnë të japin projeksione “teoriko-filozofike” për kahet dhe premisat e mendimit dhe veprimit shqiptar, gjithnjë si revolucione të cilat nisen nga argumenti i mungesës, reputacionit dhe harmonisë.

Argumenti i mungesës synon që në pah të nxjerrë “faktin” e mungesës së traditës dhe kulturës së mendimit të lirisë në civilizimin shqiptar gjatë historisë së tij. Pra, ky argument dhe përkrahësit e tij aludojnë në faktin se shumica e zhvillimeve në traditën dhe kulturën shqiptare janë zmadhime të fakteve reale, duke e paketuar varfërinë dhe resurset e pakta si traditë. Argumentet përforcohen duke theksuar se shqiptarët duke qenë popull i Kanunit dhe i një “tkurrije malore” kanë mbetur prapa zhvillimeve të caktuara dhe në fakt janë ngrysur në cektësinë e tyre kulturore. Eksperienca kulturore e tyre është e varfër, andaj duhet bërë çmos që ajo të rritet. Dhe zakonisht me “çmos” nënkuptohet një lloj revolucioni.

Argumenti i reputacionit është një argument i cili zakonisht artikulohet si mllef i dalë nga dhimbja e kësaj mungese në fushën e mendimit dhe veprimit shqiptar. Këtu thuhet se shqiptarët janë popull i papërvojë në aferat politike. Gjithçka që ata kanë zhvilluar ka qenë e fragmentuar dhe individualiste. Në të njëjtën anë, po ashtu, theksohet se kjo është traditë që duhet mohuar ngase nuk ka pasur harmoni. Ky argument zhvillohet duke marrë shembuj sporadikë për të bërë vlerësime të përgjithshme mbi “kulturën” shqiptare. Argumentet e tilla nënkuptojnë se e vetmja udhë e zhvillimit shqiptar është modelimi dhe shartimi rrënjësor me ndonjë formë të shpejtë progresiviste. Sipas këtij argumenti, gjithçka që del nga kozmologjia tradicionale është e destinuar për dështim.

Argumenti i harmonisë ndërlihd argumentet e para, duke dashur ta projektojë të ardhmen si harmoni të re të ndërtuar si përgjigje ndaj mungesës dhe reputacionit. Pra, pasi që paska mungesë dhe pasi që tradita shqiptare paska vetëm impulse të këqija, atëherë gjithçka duhet të fillojë nga e para. Argumenti kërkon që të revolucionarizohet shtegu i mendimit dhe veprimit për të krijuar një vetëdije të pastër dhe të pastruar, të bazuar në projektionin harmonik-utopik, në mënyrë që njëherë e përgjithmonë gjërat të nisin qysh i kërkon ajo utopi. Këto tri argumente janë bërë premisa të mendimit të ri ideologjik në politikën shqiptare. Ky mendim ideologjik i përçar edhe nga disa filozofë avangardistë ofron zgjidhje gjithnjë duke kundërshtuar atë që është bërë paraprakisht, e cilëso natyrë, frymë a udhë të ketë qenë ajo, si një legaci e regjimit të vjetër, si një “naivitet” politik i një populli “jo filozofik”, si një traditë e varfër e mendimit dhe veprimit politik apo si një politikë “ideologjike”.

1. Karakteristika të ligjërimit politik në Shqipëri¹

Karakteristikat e ligjërimit politik vazhdimisht formojnë kulturën politike të një populli – trajtat e ndërgjegjes politike, mënyrën se si elektorati e kupton politikën dhe qeverisjen, pritshmëritë e tij nga klasa politike, parashikimet e sjelljes dhe të strategjive politike, e të tjera. Opinionistë të ndryshëm publikë kanë denoncuar shpesh mbizotërimin, apo ndotjen gati, të ligjërimit politik në Shqipëri nga ligjërata spekulative, akuza deklarative për korrupsion, nga mosbesimi, zhvlerësimi, shpërfillja, personalizimi apo kapërcimi e sfidimi i institucioneve dhe Kushtetutës. Këto karakteristika të perceptuara të ligjërimit politik në Shqipëri janë denoncuar në mjaft raste si të papranueshme dhe si simptoma kronike të një papjekurie politike. Mirëpo pavarësisht intuitës së mprehtë, vëmendjes dhe kujtesës politike që shumë analistë sot në Shqipëri kanë dhe e ofrojnë për publikun, fakti qëndron që asnjëherë nuk kemi patur të dhëna konkrete, të nxjerra nga ndonjë studim shkencor mbi ligjërimit politik në Shqipëri. Mungesa e sistematicitetit dhe e përdorimit të metodave hulumtuese shkencore është faktor i rëndësishëm në besueshmërinë e analizave, dhe ndoshta, për rrjedhojë, edhe në ndikimin e tyre.²

Një studim i kryer nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) jep për herë të parë një pasqyrë të përafërt, por të bazuar në metoda shkencore të mënyrës sesi liderët kryesorë të politikës si dhe gazetaret me lexueshmërinë më të lartë në vend formulojnë diskursin e tyre në raport me disa çështje të rëndësishme për të cilat prej shumë kohësh zhvillohet në Shqipëri një debat i ashpër. Raporti analizon ligjërimitin e dy figurave kryesore politike, Kryeministrit Sali Berisha (Partia Demokratike) dhe Kryetarit të Partisë Socialiste Edi Rama, si edhe të 5 nga gazetave kryesore (Panorama, Shekulli, Shqip, Mapo dhe Gazeta Shqiptare) në vend gjatë dy periudhave – 3 muaj përpara dhe 3 muaj pas zgjedhjeve të 2009-ës, dhe atyre të 2011-ës. Studimi është kryer nëpërmjet programeve kompjuterike bashkëkohore për analizën e përmbajtjes (KWIC dhe Yoshikoder 7.4) dhe një grupi pune prej 7 vetash që kombinon disa profile të rëndësishme për analizë të ligjërimit, si shkencat politike (Silvana Toska, Adela Halo, Sonila Danaj, Dorina Ndoj), gazetaria (Sokol Shameti), filozofia (Ani Rusi), dhe gjuhësia (Prof. Emil Lefe).³

Synimi i grupit të punës ishte të analizonte: Si e përshkruajnë Sali Berisha dhe Edi Rama njëri-tjetrin dhe mbi çfarë bazash bëhen këto përshkrime (karakter personal, arritje, ideologji)? Sa përputhet ligjërimiti i aktorëve në secilin krah politik me ideologjitë përkatëse politike (e majta dhe e djathta)? Si trajtohen gratë, feja dhe minoritetet në ligjërimitin e pushtetit, opozitës dhe shtypit të shkruar? Si trajtohet integrimi në BE në ligjërimitin e pushtetit, opozitës dhe shtypit të përditshëm? Si trajtohen institucionet në ligjërimitin e pushtetit, opozitës dhe shtypit të shkruar?⁴

¹ <http://al.ejo-online.eu/1200/politika-e-medias/karakteristika-te-ligjerimit-politik-ne-shqiperi>

² Adela Halo, Karakteristika të ligjërimit politik në Shqipëri, 24 Janar, 2013, <http://al.ejo-online.eu/> (qaur me 11.01.2015)

³ Adela Halo, Karakteristika të ligjërimit politik në Shqipëri, 24 Janar, 2013, <http://al.ejo-online.eu/> (qaur me 11.01.2015)

Po aty.

Për të analizuar përputhjen partiake me ideologjitë përkatëse (e djathta dhe e majta) në Shqipëri, pikënisja e studimit ishte një fjalor ekzistues i përdorur nga dy studiuesit Laver dhe Garry (2000), të cilët e ndërtojnë leksikonin e djathtë dhe të majtë në kategori të tilla si: institucionet; ligji dhe rendi; mjedisi; çështjet social-ekonomike, dhe vlerat. Si konkluzion i studimit del se me përjashtim të çështjes së Mjedisit dhe disi asaj të institucioneve, ligjërimi i djathtë është më i pranishëm se ai i majtë. Kjo nuk çon automatikisht në përfundimin se një ligjëruar apo dokument është i djathtë: mund të themi vetëm se ky dokument përmban një pjesë të madhe të leksikut të djathtë që mund të jetë për dy arsye të mundshme: ose ky dokument është vërtet i djathtë, ose ky dokument përmban kritika ndaj ligjërimin të djathtë. Sidoqoftë, ligjërimi i majtë është mjaft i pakët edhe në liderin e majtë edhe nëpër gazeta. Në rastin e Ramës, në bazë të numrit relativisht të vogël të ligjërimin të majtë në krahasim me atë të djathtë tregon një ligjërim që anon më tepër në kritika se sa në ofrimin e një alternative të majtë të matshme krahasimisht në ligjërim.

Studimi nxjerr përfundime të rëndësishme në lidhje me ligjërimin e aktorëve politikë mbi gratë, grupet fetare dhe minoritetet. Kështu, ligjërimi për dhunën ndaj grave ka ardhur në rritje dhe nuk ka ligjërim fyes ndaj minoriteteve etnike. Çështjet e grave përmenden më shpesh nga lideri i Partisë Socialiste, sidomos në lidhje me mbështetjen e përfaqësimit politik dhe të raportimit të dhunës ndaj grave. Ndërsa për fenë dhe minoritetet prononcohet më shpesh lideri i Partisë Demokratike. Por ndryshe nga figurat politike kryesore, pothuajse asnjë nga gazetaret nuk e diskuton temën e mbështetjes së përfaqësimit politik të grave me të njëjtën shpeshësi sesa barazinës.

Për sa i përket ligjërimin mbi Bashkimin Europian dhe Evropën në përgjithësi, të dy figurat politike si dhe gazetaret e përditshme duket se e kanë prioritet kryesor. Por ndërsa ligjërimi për BE-në në terma të përgjithshëm është i lartë, ligjërimi për reforma të caktuara në qendër të integritit është i ulët, me përjashtim reformës zgjedhore dhe asaj në drejtësi.

Studimi i OSFA merr në analizë edhe ligjërimin mbi institucionet në vend. Çdo gazetë si dhe deklaratat e Ramës kanë ardhur duke theksuar kritikën mbi integritetin e institucioneve dhe sfidimin e kërcënimit ndaj tyre, ndërkohë që Berisha ka rritur vetëm ligjërimin mbi sfidimin dhe kërcënimin e institucioneve. Kjo është interesante pasi anë të kundërta në politikën në vend – Rama dhe Berisha – të dy ose i sfidojnë e kërcënojnë institucionet, ose i quajnë ato të sulmuara nga pala kundërshtarë.

Për sa i përket nën-kategorive të ashtuquajtura “pozitive”, ku renditen fjalë që potencialisht shprehin vlerësim për institucionet, ky studim është më pak i sigurt, pasi fjalët brenda këtyre nënkategorive mund të jenë ose një shprehje dëshire për integritet dhe funksionim, ose kritikë ndaj mungesës së integritetit dhe jo-funksionimit, ose premtime. Sidoqoftë, duke marrë parasysh se të paktën disa nga këto fjalë janë faktikisht kritika ndaj institucioneve, kjo e thëllon akoma më tepër konkluzionin se në Shqipëri ligjërimi ndaj institucioneve është kryesisht, dhe në një pjesë dërmuese, negativ dhe sidomos për sa i përket integritetit të tyre.

2. Tiparet e komunikimit

Një analizë e këtij procesi kërkon së pari një prerje tërthore dhe vëzhgim të hollësishëm të tipareve më të rëndësishme të tij. Artan Fuga i referohet medias si mjeti më i mirë i propagandës së partive politikë për të komunikuar në atë që ai e quan politikë të elektoratit, pra lexuasit të gazetave⁷ duke i atribuar gazetave rolin e mbrojtësve të votuesve të ardhshëm. Nisur nga hapat e parë të mburrjes së procesit të komunikimit vlen të përmendet një prej tipareve të tij më të rëndësishme në fillim të viteve '90: lidhja mes ekzistencës së një organi të medias (në atë kohë bëhej fjalë vetëm për shtypin e shkruar) dhe mbijetesës së partive politike. Pra përcjellja e ideve politike tek elektorati bëhej vetëm dhe ekskluzivisht nëpërmjet organit të shtypit duke marrë parasysh edhe kushtet e mjerueshme infrastrukturore të Shqipërisë së viteve '90. Në fakt sa më e thjeshtë dhe eksplicite të qe gjuha, aq më e perceptueshme dhe e kuptueshme bëhet ideja për qytetarin duke konsideruar këtu faktin që partitë e sapokrijura kishin nevojë të shtriheshin në hapësirë dhe të mbulonin edhe territorin më të thellë rural, një ambient potencial për t'u përkthyer në vota dhe elektorat në zgjedhjet politike⁸.

Një tipar tjetër i rëndësishëm i procesit të komunikimit që sapo kishte filluar të bulëzonte edhe pse në formë shumë të thjeshtë dhe primitive ishte edhe shtrirja e përhapjes së mesazhit politik në kohë dhe hapësirë nëpërmjet gazetave më të rëndësishme në vend. Fuga e argumenton këtë tezë duke marrë për shembull zgjedhjet e para të lira të zhvilluara në Shqipëri në 31 mars 1991 dhe rezultatin që doli prej tyre. Sipas analizës së tij, komunistët fituan sepse ata kishin në dispozicion gjithë shtypin qendror plus edhe rreth 20 gazeta lokale të komiteteve të partisë në rrethet, situatë kjo që u përmbys në zgjedhjet e 22 marsit 1992. I atribuohet pikërisht shtimit të numrit të gazetave opozitare, shpërndarjes së tyre në të gjithë territorin e vendit dhe tkurrjes së fuqisë propaganduese të Partisë së Punës së shndërruar në Parti Socialiste përmbysja e rezultatit dhe fitorja plebishitare e forcave opozitare duke shënuar kështu qeverinë e parë jo komuniste që prej vitit 1944 në Shqipëri¹⁰.

Vlen për t'u përmendur në këtë rast edhe shembulli i zgjedhjeve parlamentare të 3 korrikut 2005 kur shumica e opinionit publik përfshirë këtu edhe mediat kryesore të shkruara dhe elektronike parashikonin një fitore të Partisë Demokratike prej

Adela Halo, Karakteristika të ligjërimin politik në Shqipëri, 24 Janar, 2013, <http://al.ejo-online.eu/> (qaur me 11.01.2015)

Adela Halo, Karakteristika të ligjërimin politik në Shqipëri, 24 Janar, 2013, <http://al.ejo-online.eu/> (qaur me 11.01.2015)

Fuga, I kja nga kompleksi i Rozafës, 25.

Irida Vorpsi, Rhetorik und Kommunikation in der Albanischen Politik, Individuelles Masterstudium: Global Studies – a European Perspective, Wien, 2009

Fuga: Media, politika, shoqëria, 22-27

Irida Vorpsi, Rhetorik und Kommunikation in der Albanischen Politik, Individuelles Masterstudium: Global Studies – a European Perspective, Wien, 2009

8 vitesh në opozite dhe fitore që: konvertimi i opinionit mbizotërues në masmedia në këtë rast me atë të elektoratit për një ndryshim në qeverisje nuk mund të konsiderohet rastësi. Ndikimi është i ndërsjellë: media ndikon politikën dhe ndikohet prej saj duke formësuar një proces komunikimi kompleks dhe shumë planësh.

Gjuha natyrisht luan një rol të rëndësishëm në procesin e komunikimit, por jo vetëm në të. Ajo ka një peshë jo të vogël në formësimin e identitetit duke u identifikuar me një element thelbësor në bërjen dhe përfaqësimin e tij.

Gjuha mund të shihet edhe si një ndërmjetës, një mjet që politika përdor për të kontrolluar dhe influencuar elektoratin duke shfrytëzuar fuqinë që ajo ka mbi mendimin. Gjuha e politikës në fakt mbështetet në elementë të rëndësishëm që do të dalin në pah më poshtë duke i ilustruar me shembuj. Gjuha nuk është vetëm arti i të shprehurit, përkundrazi ajo mund të shprehë më shumë duke mos u prononcuar në mënyrë eksplicite, por duke nënkuptuar si në frazën e mëposhtme të artikuluar nga ish Presidenti i Republikës, Bamir Topi:

Sistemi i drejtësisë merret me konfliktet e çfarëdolloj natyre dhe këtu është e qartë që konfliktet eventuale të mundura të subjekteve politike në funksion të rezultatit të zgjedhjeve mund të angazhojnë në mënyrë të qartë edhe Kolegjin Zgjedhor, i cili është i mandatuar dhe padyshim sot edhe një herë dëshiroj të shprehem në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për pritishtësinë e lartë që ne kemi për këtë Kolegj: për të realizuar detyrën mjaft të rëndësishme, mjaft delikate, sepse sikurse dihet vota e sistemit të drejtësisë është pikërisht në ndërgjegjen e çdo gjyqtari.¹¹

Në mënyrë implicite President i Republikës i jep zë shqetësimeve që kanë karakterizuar situatën post zgjedhore për një anësi të organeve kushtetuese siç është Kolegji Zgjedhor pa i përmendur ato në mënyrë eksplicite, por duke theksuar pritishtësinë e secilit prej nesh që ky organ të jetë në lartësinë e duhur duke iu kujtuar atyre dy elementët ndaj të cilëve janë të detyruar të binden: kushtetuta dhe ligji. Mes rreshtave lexoj se Presidenti shmang çdo lloj elementi tjetër të natyrës partiake apo personale në gjendje të ndikojë vendimet e këtij organi.

Një element tjetër që përdor gjuha në procesin e komunikimit është edhe persuazioni ose përdorimi i retorikës në funksion të argumentimit duke shfrytëzuar një sërë figurash letrare si metafora dhe eufemizmi, por jo vetëm. Elementët e sipërpërmendur mund të përforcohen nga përdorimi i dialektit, lëvizje taktike kjo që përdor politika për t'u shfaqur më pranë komunitetit duke shfrytëzuar ndikimin psikologjik tek audienca.

"A jeni dakord ju që në krye të listës së LSI-së përfaqësimit në kuvendin e ri të Shqipërisë të jetë kampioni i Vllaznisë, kampioni i Shqipërisë, kampioni i qytetarisë dhe qytetarisë shkodrane Seit Fishta. Ka dhe shumë të tjerë por këto diskutojini dhe zgjidhni vetë. Unë jam i bindur se me këta dy Sokola të qytetarisë Shkodrane të traditave më të mira shkodrane, të faljeve më të mira shkodrane.¹²"

Jo më kot një nga pyetjet e përzgjedhura për t'u drejtuar të intervistuarve ka të bëjë pikërisht me përdorimin ose jo të dialektit gjatë procesit të komunikimit dhe analizimi i saj në kapitullin në vijim do të plotësojë kornizën e rolit të gjuhës në ndërtimin e procesit të komunikimit. Ajo çka bie në sy në analizën e gjuhës, një nga elementët me të cilën materializohet procesi i komunikimit në Shqipëri, është prania e dhunës verbale si element jetësor të klasës politike. Kjo dhunë nuk ka hiç respekt as për familjen tradicionalisht të konsideruar një vlerë shumë të rëndësishme të shoqërisë shqiptare, të paprekshme gati gati tabu duke përfshirë në fyerje gjininë femërore me qëllimin diabolik për të prekur sedrën mashkullore dhe për të provokuar tek tjetri një reagim të shpërfytyruar. Një rast i tillë fatkeq është shënuar pikërisht në tempullin e demokracisë, në një seancë parlamentare duke dokumentuar një pikë kulminante të provokimit dhe denigrimit të kundërshtarit politik me çdo mënyrë.¹⁴ Përpos skuqjes dhe ndjenjës së turpërimit që ngjall kjo video tek çdo njeri me një ndjenjë mesatare qytetarie, ajo tregon më së miri sesi tri përfaqësues të organeve kushtetuese Kryeministri, Kryetarja e Parlamentit dhe një deputet i grupit parlamentar socialist të Republikës së Shqipërisë shprehen me një gjuhë të padenjë duke qenë në detyrë. Skena bëri xhiron e menjëhershme në një shoqëri, e cila përdor edhe elementët më të shpejtë të komunikimit dhe jo më kot unë sugjerova si burim pikërisht shfaqjen që serviret në youtube.

Mund të përjetohet edhe pasi kanë kaluar vite sikur të ndodhte në kohë reale. Megjithatë nuk dua të ndalem në rolin e medias dhe mënyrën sesi ajo prodhon politikë në këtë rast, por në fuqinë demonizuese dhe stigmatizuese të gjuhës.

Impakti tek publiku qe tronditës. U dëgjuan zëra që i dënuar, por fasha e simpatizantëve të njërit apo tjetrit krahu nuk u dyzua shumë, përkundrazi nuk vonoi të radhitej në krahu përkatës e të sulmonte kundërshtarin me të njëjtin mllef si provokator apo dashakeq.

Ky rast vërteton teorinë e Fugës që tërheq vëmendjen për një patologji nga e cila vuan edhe publiku shqiptar: mpirjen dhe anestezimimin¹⁵ e tij duke u imunizuar në një ambient ku të gjithë flasin dhe asnjë nuk dëgjon. Në kuadrin e një ambienti kakofon, gati gati kalohet në desamentizim të fjalëve të përdorura. Gjuha në këtë rast luan këtë funksion mpirës në kuadrin e një kakofonie kolektive, në të cilën zor se mund të ketë vend për një ndjekje logjike të ngjarjeve dhe gjykim të paanshëm. ¹⁶ Pra duhet të jemi të kujdesshëm në përkufizimin e gjuhës si element bashkues që është thelbësor në ndërtimin e një komuniteti. Po aq i mprehtë është edhe roli i saj ndarës si në shembujt e përmendur më sipër që analizohen gjithmonë brenda

kontekstit të përdorur. ¹⁷

Fjala e Presidentit Topi në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. <http://www.president.al/shqip/info.asp?id=5102>

Irida Vorpsi, Rhetorik und Kommunikation in der Albanischen Politik, Individuelles Masterstudium: Global Studies – a European Perspective, Wien, 2009

Fjala e Ilir Metës mbajtur në Shkodër 03.03.2009 <http://www.24-ore.com/mobile/politika/2720.html>

<http://www.youtube.com/watch?v=fD7LZcbi-D8>

Fuga: Brirët e Dhisë, 435

Irida Vorpsi, Rhetorik und Kommunikation in der Albanischen Politik, Individuelles Masterstudium: Global Studies – a European Perspective, Wien, 2009

Po aty.

3. Sharja në politikë¹⁸

Tashmë edhe ne shqiptarët u mësua me sharjet në politikë. I dëgjojmë shpesh kundërshtarët të shahen në parlament, në televizion, në shtyp, në tubime. Hapësira politike shndërrohet shpesh në mejhane të vjetra ku fluturojnë lloj lloj sharjesh, që ndonjëherë duket sikur kanë dalë nga muret e nevojtove publike, ku lihen ndyrësira verbale çfarëdo.

Para se të kuptojmë se ç'janë sharjet në politikë, duhet të pranojmë se nuk janë veçori e shqiptarëve. Në të gjitha vendet, ku më shumë e ku më pak, janë të pranishme sharjet, si në rrugë ashtu edhe në politikë, gjithnjë duke respektuar parametrat kulturorë, meqë jo të gjithë popujt shajnë njëlloj. Megjithatë, vihet re se në Shqipëri sharjet janë strukturuar tashmë në ligjërimin publik, në mos nga ana formale, të paktën nga pikëpamja e regjistrit të komunikimit. Me fjalë të tjera, sharja në skenën publike shqiptare është pjesë përbërëse e “komunikimit politik”.¹⁹

Në të vërtetë sharja është infarkti i komunikimit, sepse momenti që ndodh përkon me dëmtimin e rëndë të shkëmbimit të informacioneve, ose të dialogut politik. Sharja i jep fund ecurisë normale të komunikimit, me rrezikun e moskthimit mbrapa, përdërisa shpeshherë sharja shikohet si fjala e fundit, ose gjithsesi si ajo mënyrë komunikimi që lë shenja të pashlyeshme.

Sharja shënon edhe bllokimin e mendimit. Sikurse në trafikun e rënduar aksidenti i rëndë nuk e lejon më qarkullimin, ashtu edhe procesin e dialogut sharja e mbyll procesin e mendimit. Në fakt, në komunizmin e përditshëm as atij që shan, as atij që shahet, nuk i kërkohet ndonjë mendim i veçantë. Përkundrazi, dinamika e sharjes e përjashton arsyen, si rrjedhim e shmang mendimin i cili, le ta kujtojmë, është thelbi i politikës.

E megjithatë, e tregojnë edhe shembujt e shumtë në politikën shqiptare, ekziston rreziku që sharjet të konsiderohen si mënyrë normale komunikimi, ndërkohë që kemi të bëjmë me surrogato të tij, e në disa raste me ato forma të jetës që vazhdojnë për inerci edhe pas vdekjes. Rreziku qëndron pikërisht në ndjesinë se po bëhet politikë, se dialogu vijon, ndërkohë që sharjet nuk kanë të bëjnë asfare me përplasjet ideore në politikë.

Që sharjet në politikë koincidojnë me pezullimin e kësaj të fundit e tregon qartë edhe forma skenike ku merr jetë komunikimi mes palëve në lojë. Pavarësisht se publiku ka ndjesinë se po bëhet politikë, sharjet e përjashtojnë krejtësisht atë nga pjesëmarrja, që siç dihet ndodh edhe gjatë shfaqjeve teatrale, ku spektatorët marrin pjesë emotivisht në atë çka ndodh në skenë. Mirëpo sharjet, duke e rënduar deri në skaj fjalën me konotacione negative, e sterilizojnë dialogun, duke e lënë jashtë publikun, i cili ka iluzionin fillestar se po përfshihet në zgjedhjet e vendit, porse në të vërtetë është thjesht spektator i një komunikimi të dështuar.²⁰

Deri në një farë mase ‘communis opinio’ e toleron sharjen, sepse e konsideron atë pjesë të pasionit politik, ku fjalët i shpëtojnë ndonjëherë doganës verbale të trurit. Mirëpo kufiri midis sharjes si përjashtim dhe sharjes si modus komunikimi është shumë i lehtë për t’u kapërcyer, madje pa e ndërë fare. Problemi është se edhe ne shqiptarët jemi mësuar gradualisht me sharjet, sikurse ndodh me dozat e helmit ose të drogës; në fillim të bën përshtypje edhe një fjalë e pamenduar mirë, pastaj shkopi i kërcimit së larti të akrobacive verbale ngrihet më tej, deri sa kalohet pa e kuptuar mirë në caqe të papranueshme, me sharje të rënda edhe për garipat vetë. Trupi shoqëror mësohet ngadalë me përshkallëzime të tilla, derisa të verifikohet kolapsi komunikativ, çka do të thotë fundi i politikës, që nuk njoftohet për fat të keq me tinguj trombësh, por vihet re në realitetin e vendit.

Në qoftë se parlamenti është sheshi, rrugica, oda e djeshme, atëherë është vendi i ligjëritimit, ku ushtrohet fjala, diskutimi, e ndonjëherë polemika, por pa arritur kurrë në konflikte verbale siç është sharja, e cila me konvencion nuk e ka vendin aty, sepse nuk është funksionale ndaj dialogut. Në kuptimin figurativ, sikurse lihen jashtë armët para se të hyhet në kuvend, ashtu duhen lënë jashtë edhe armët verbale vdekjeprurëse, si sharjet, që e vrasin fjalën nuk e vitalizojnë atë.

Sipas filozofit Roberto Esposito, sharja mund të ketë efekte politike, siç mund të jetë për shembull devijimi i vëmendjes së publikut në diçka tjetër; megjithatë, nuk i përket gjuhës së politikës, sepse është “shkak dhe efekt i shpolitizimit, në kuptimin që e shpie praktikën politike në një fazë belbëzuese, në mos drejt afazisë”. Këtu, ne shqiptarët, si qytetarë duhet ta pyesim gjithnjë veten kur niveli i sharjeve i kalon nivelet fiziologjike, për të kuptuar nëse kanë funksionin e shashkave, pra zhvendosjen e vëmendjes diku tjetër. Përshtypja është se kjo manovër bëhet shpesh në politikën shqiptare, qoftë edhe për të maskuar mos ekzistencën e politikës me P të madhe.

Nuk ka dyshim se komunikimi politik, që ka nevojë për “pullë e kuqe” kur i jepet publikut, ka lidhje me edukimin e qytetarëve. Nuk mund të pretendohet që sharjet të mos kenë efekt mbi publikun dhe që brezat e vjetër e të rinj të mos ndikohen nga sharjet në parlament ose në arenën politike. Politika është produkt i kulturës së një vendi, por njëkohësisht edhe aktor i saj, në kuptimin që merr pjesë në formimin e kulturës politike. Nuk ka dyshim gjithashtu se sharjet shkojnë e ndërveprojnë me procese relativisht të reja në kulturën moderne, siç është spektakolarizimi i politikës, mediatizimi, liderizmi, e kështu me radhë.²¹ Politika e mediatizuar, ose e personalizuar, që ndiqet obsesivisht nga telekamerat, krijon kushte ideale për forma të skajshme të shprehjes, siç janë sharjet, të cilat në analizë të fundit na japin shansin të reflektojmë për shoqërinë dhe politikën e sotme.

4. Morali i komunikimit politik shqiptar

Komunikimi politik nuk është i lidhur vetëm me profesionet e gazetarisë politike. Aq më shumë që jo çdo informacion në media ka natyrën e një komunikimi politik. Ai nuk mund të ngatërrohet as me komunikimin publik që është një koncept i

<http://peizazhe.com/2014/04/07/sharja-ne-politike/>

<https://randodevole.wordpress.com/2014/04/13/sharja-ne-politike-ii/>

<https://randodevole.wordpress.com/2014/04/13/sharja-ne-politike-ii/>

<https://randodevole.wordpress.com/2014/04/13/sharja-ne-politike-ii/>

ndryshëm. Komunikimi politik i tejkalon, duke i përfshirë brenda vetes, edhe mundësitë shprehëse të zëdhënësve të partive politike, të institucioneve politike, të shtetit si të tillë. Ai përfshin gjithashtu brenda vetes, pa u kufizuar aspak atje, edhe ato marrëdhënie komunikative sy më sy mes politikanëve në debatet e tyre, mes politikanëve dhe qytetarëve, si edhe dialogun qytetar mes politikës atje ku ai kryhet në jetën e përditshme jashtë mediave, sado që ndofta i rimarrë prej tyre. Nuk mund të anashkalohej nga pikëpamja e rëndësisë edhe dialogu politik që shprehet në forumet, blogjet, facebook-et, pra kudo ku nëpërmjet web-it internautët trajtojnë me pasionet që i karakterizojnë çështje të politikës, japin mesazhe politike, shprehin bindje dhe qëndrime politike, reflektojnë sipas mënyrës dhe stilit të tyre dhe brenda mundësive të medias, për politikën dhe politikanët. Politika nuk është vetëm çështje e institucioneve politike, por edhe e vetë qytetarit, individual apo të organizuar, kur ai u drejtohet çështjeve të pushtetit. Mbi të gjitha nuk duhet dhe nuk na lejohet ta thjeshtëzojmë kuptimin e komunikimit politik vetëm te përmbajtja e tij. Përkundrazi, një anë po aq e rëndësishme ka të bëjë me format, teknikat shprehëse dhe bindëse, artin formal të komunikimit politik dhe të retorikës politike, të komunikimit jo verbal kudo ai që kryhet, në media apo në komunikimin sy më sy.

Kuptohet që në secilën nga këto praktika të komunikimit politik, çështja e moralitetit shtrohet ndryshe dhe ka një kuptim të veçantë. Sa për të marrë një shembull, do të thoshim se shpesh në forumet në internet, shprehen qëndrime dhe ka reagime tepër të sinqerta për politikën ose për gazetarët e politikës apo për politikanët. Deklarime të guximshme që shpesh janë interesante, edhe pse disa shkojnë drejt kufijve të fyerjes personale. Këtu nuk ka aq rëndësi përmbajtja, por fakti që autorët e këtyre deklarimeve në shumicën e tyre janë anonimë dhe me identitet të fshehur. Ndoshta pikërisht këtu qëndron edhe dobia e kësaj forme të komunikimit politik, i cili bëhet duke çliruar një sinqeritet tronditës. Por, nëse ne e trajtojmë me një tolerancë morale faktin e anonimitetit të dialoguesve në forume, nuk do të bënim kështu nëse dikush, në një mbledhje apo në një miting politik, do të hipte në tribunë dhe me kokën e fshehur, futur në ndonjë thes do të bënte deklarata politike radikale nëpërmjet fjalimesh patetike. Në këtë rast audienca do ta kishte quajtur këtë veprim si amoral, të padenjë dhe forca bindëse (persuasive) e komunikuesit do të kishte qenë pothuajse e paqenë. Po kështu edhe llojet e veprimtarisë politike janë kaq të pasura dhe të ndryshme prej njëri-tjetrit, sa që është e vështirë të gjenden kritere morale unike dhe shteruese për t'i gjykuar me të njëjtën masë. A mund të gjykohej, ta zëmë, me të njëjtën masë etike edhe gazetari që drejton një emision televiziv, i cili në etikën e tij profesionale është i detyruar të tregohet korrekt dhe t'i trajtojë të ftuarit e tij politikanë me të njëjtin respekt, edhe politikanët, të cilët jo medoemos kanë respekt, madje nuk u kërkohet të kenë respekt si politikanë (jo si genie njerëzore) për njëri-tjetrin? Sigurisht që këtu kemi disa standarde morale që ndryshojnë nga njëri-tjetri.

Po aq i disallojësh është edhe kuptimi i moralit, i morale, i moralitetit. Në teorinë për etikën, tradicionalisht flitet për moral të detyrës, çka do të thotë se në këtë prizëm normat morale shihen si detyra për t'u realizuar medoemos, të shprehura në mënyrë tepër të saktë dhe konkrete. Ka moral të frymëzimit, i cili kufizohet në kërkesën që njeriu të vendosë përpara vetëm disa qëllime të përgjithshme, ku orientimi në përputhje me to e bën sjelljen njerëzore të mirë ose të keqe. Po kështu, brenda moraleve utilitariste e mira është ajo që sjell dobi për shumicën e njerëzve dhe u sjell atyre kënaqësi. Ndërkaq, morali i efikasitetit (suksesit praktik) kërkon që norma morale ta vlerësojë si të mirë ose të keqe, të drejtë ose të padrejtë, atë veprim ose një tjetër vetëm në funksion të dobisë praktike që ajo sjell për njerëzit.

Si do ta quajmë një komunikim politik kur deklarohet brenda tij se vendi ndodhet para dhe nën efektin e pasojave të një krize financiare globale dhe se ekonomia po përballlet me rrezikun e falimentimit? Si një komunikim politik i moralshëm, sepse ndofta i vërtetë? Si një komunikim politik të moralshëm, sepse ndofta kërkon një vëmendje më të madhe të politikave publike ndaj risqeve të sotme financiare? Apo si një komunikim të pamoralshëm, sepse duke nxirë tablonë ekonomike të vendit sjell pasoja negative në investime, nxit mosbesim në sistemin bankar, pra prodhon vetiu parakushte të një krize që kërkon të paralajmërojë? Si do ta konsideronim një deklaram politik se vendi nuk kërcënohet nga gripi me virusin A? Si një deklaram të pamoralshëm, sepse mund të fshehë të vërtetën? Apo si një deklaram të moralshëm, sepse meqë nuk ka vaksina për të gjithë popullsinë, ai ndihmon që të ruhet qetësia, të mos krijohet panik, të krijohen mundësi që autoritetet publike ta përballojnë qetësisht situatën? Pra, nga çfarë pikëpamje morale do ta kishim gjykuar? Nga ajo e përpalljes me të vërtetën apo nga pikëpamja e dobisë praktike në të mirë të dobisë publike?

5. Ikja nga etika magjike

Lindja e komunikimit të lirë politik historikisht lidhet, sikurse argumenton Jurgen Habermas në veprën e tij Hapësira publike, me lindjen e sferës publike, pra si një mjedis i lirë, i bërë i mundur nga strukturimi i dallimit midis shtetit dhe shoqërisë. Revolucionet e shekujve të 17-të dhe të 18-të e rihapën gradualisht rrugën drejt këtij modeli shoqëror, i humbur prej kohësh, pavarësisht se të shoqëruara me të gjitha ato zigzage që njeh historia. Modeli i shtetit të së drejtës kaloi nga librat dhe traktatet politike teorike, nga pamfletet, drejt lëvizjeve shoqërore dhe krijimit të institucioneve politike të bazuara në këto vlera. Liritë qytetare nënkuptuan edhe të drejtën për lirinë e shprehjes së besimeve dhe opinionëve fetare, kulturore dhe politike. Në këtë mënyrë u hap edhe rruga për atë hap e hop të madh në historinë politike pararendëse të vendeve që hynë në rrugën e demokratizimit dhe që e ndau shtetin nga feja. Parimisht, ligji, në radhë të parë, pastaj edhe simbolika institucionale, rregullat administrative, marrëdhëniet e varësisë dhe të hierarkive burokratike, ndërtimi i modelit të shtetit, të drejtat dhe liritë qytetare, tanimë nuk ishin më as nën kontrollin e fesë dhe të institucioneve fetare, por edhe as nuk gjenin legjitimitetin e tyre më në etikën fetare, ose sikurse e quan Habermas në librin e vet Teoria e veprimit komunikativ, në etikën magjike, çka është edhe një koncept më i gjerë dhe më i shtrirë historikisht.

Lindja e rrymave politike laike dhe e mediave laike, në një farë mënyre laicizimi i shoqërisë, për të mos harruar thelbësisht krijimin e modeleve shtetërore laike, solli atë që një pjesë e konsiderueshme, ndofta ajo mbizotëruese, e komunikimit politik të marrë një distancë relativisht të qëndrueshme dhe të dallueshme nga morali fetar. Gjithsesi, morali fetar, me shumë ndikime historike mbi moralin e familjes, atë të jetës së përditshme, quajtur shpesh si moral universal, e ka të vështirë të shërbejë si tërësi normash etike për komunikimin politik në kushtet e shoqërive të masmedias dhe komunikimit. Bota e përvijuar nga feja, e cila ka luajtur një rol pothuajse ekskluziv në edukimin moral të njeriut, është ajo e qiejve, kurse bota profane e Tokës kërkon përjasje specifike. Kur Jezusi nxori fjalët e tij duke thënë se jepini Zotit atë që i takon Zotit dhe Cezarit atë që i takon Cezarit, ai e rinjohu këtë ndarje midis botës së shpirtit dhe botës materiale, të ekonomisë dhe politikës. Ka një pamundësi pothuajse të pakalueshme për të bërë që në mënyrë mekanike të shkohet nga disa parime të përgjithshme etike drejt disa detyrimeve konkrete që rrjedhin forcërisht prej tyre. Morali i përgjithshëm magjik, në format e veta universale, shprehet ose në formën e detyrave bazike (“Ti nuk do të vrasësh më!”), ose në formën e frymëzimeve abstrakte (“Duaje si veten të afërmin tënd!”). Një nga autorët më të njohur të filozofisë të së drejtës, Lon F. Fuller, shkruan: “Moraliteti i frymëzimit shpjegohet në mënyrën më të plotë në filozofinë greke. Ai është mentaliteti i Jetës së Mirë, i së përkryerës, i realizimit të plotë të pushteteve njerëzore... Ndërsa moraliteti i frymëzimit nisët nga maja e realizimeve njerëzore, morali i detyrës nisët nga fundi. Ai mbështetet te rregullat bazë pa të cilat një shoqëri e rregullt nuk mund të ekzistojë apo pa të cilat një shoqëri e orientuar drejt disa qëllimeve mund të dështojë. Ky është moraliteti i Testamentit të Vjetër dhe i Dhjetë Urdhëresave”.

Qëllimet morale mund të arrihen me mjete të ndryshme. Është shpesh e pamundur për të ditur nëse një mjet politik, ekonomik, administrativ, teknologjik etj., i shërben një qëllimi të lartë të së ardhmes apo e pengon atë. Rrugët për t’ia mbërritur mund të jenë të shumta, ndofta të pafundme. Në këtë mënyrë bëhet jo e lehtë të gjykohet për një akt politik ose komunikimi politik. Lidhja mes qëllimeve morale dhe akteve konkrete nis dhe humbet. Së paku bëhet objekt debatesh. Nga njëra palë mjeti i përzgjedhur konsiderohet si moral, nga pala tjetër gjykohet si i pamoralshëm. Jozef Raz, studiues shumë i njohur i marrëdhënieve mes politikës dhe moralit e shpreh kështu këtë vështirësi: “Arsyet për të vepruar e transferojnë forcën e tyre te mjetet me anë të të cilave kryhet realizimi i tyre. Nëse unë kam një arsye për t’ju sjellë juve një gotë me ujë, atëherë kam arsye për të shkuar në kuzhinë për të marrë një gotë dhe për ta mbushur me ujë. Por, megjithëse kam detyrimin për të qenë në Londër në mesditë, këtë nuk del se jam i detyruar të marr trenin e orës dhjetë të paradites, ndonëse ai mund të më çojë në Londër në mesditë”.

Edhe nga pikëpamja e moralit të detyrës do të ndodheshim përpara të njëjtave vështirësi. Duket sikur disa detyrime morale bazike janë universale dhe të detyrueshme për ta quajtur çdo akt njerëzor të moralshëm. Deri në një farë mase, por jo edhe në çdo rrethanë. Fuller thotë se, bie fjala, të quash mbijetesën, pra ruajtjen e jetës së vetes, si vlerë parësore, duket si një normë morale e padyshimtë. Por, në librin e tij të sipërpërmendur, ai hedh dyshime edhe mbi këtë gjë. Të mbijetosh edhe atëherë kur jeta është bërë e padurueshme? Edhe në kushtet e një mjerimi të tejskajshëm? Edhe në kushtet kur revolta që mund të rrezikojë jetën, duket si e pashmangshme? A është pra ruajtja e jetës së vetes një vlerë morale e padiskutueshme dhe që mund të komunikohet në çdo rast dhe rrethanë si e tillë?, - pyet Fuller me autoritetin e tij. Përgjigjja që jep është shumë larg për t’u quajtur pa diskutim pohuese.

Aq më shumë e vështirë bëhet për të gjykuar për moralitetin e përmbajtjes së komunikimit politik në kushtet e shoqërive me një diversitet kulturor, fetar, krahinor, etnik etj. të theksuar. E njëjta gjë ndodh në kushtet e shoqërive që kanë dalë nga një histori relativisht e gjatë ndarjesh civile. Sot në Shqipëri, sido që ta komunikosh politikisht shprehjen: “Dita e çlirimit është 28 nëntori”, ose shprehjen tjetër: “Dita e çlirimit është 29 nëntori!”, gjykohesh rëndë moralisht. Nga pikëpamja e qëllimeve, pra frymëzimeve, ajo mund të konsiderohet në të dyja rastet si e moralshme, e virtutshme, sepse përkujton një ditë historike për kombin. Por, gjithsesi, si “mjet”, mbetet e papranueshme nga këndvështrime konfliktuale historike, politike dhe morale. Mjafton të shohim mediat shqiptare të sotme për të konstatuar se ata që e quajnë 28 nëntorin si festë çlirimi nga pushtuesit nazistë anatëmohen nga kundërshtarët e tyre si bartës të devijancave morale, për të parë gjithashtu se si ata që si datë të tillë konsiderojnë 29 nëntorin, gjykojnë rreptësisht në planin moral sikurse edhe në atë politik. Në këtë rrafsh, normat morale që gjykojnë komunikimin politik, sidomos në rrafshin e përmbajtjes së tij, janë diferencuar dhe nuk arrijnë të gjejnë një konsensus. Nuk mund të mohohet se një opinion i lirë publik nuk mund të privohet nga kjo përmasë pluraliteti etik. A mundet ai në këto kushte të gjykohet nga vlera etike universale? Do të ishte e vështirë.

Edhe morali popullor, që duket aq universal si gjykim etik, shpesh është i pamjaftueshëm për të gjykuar moralitetin e akteve të komunikimit politik. Këtu nis edhe një e çarë tjetër morale midis gjykimit të masës së qytetarëve, shpesh nën ndikimin e vlerave etike popullore, dhe detyrimeve dhe nevojave të politikanëve për të vepruar në përputhje me situatat politike koniunkturale, për të ndryshuar strategji, për t’u përshtatur me kushtet e ndryshueshme të marrëdhënieve politike dhe të reformimit të strategjive politike të rivalëve të tyre politikë. Politikani është i detyruar, edhe atëherë kur nuk dëshiron, që shpesh të ndryshojë ato që ka thënë më parë, qoftë në zjarrin e betejave politike, qoftë në rrjedhat e reja, shpesh krejt të kundërta me ato të mëparshmet, të politikës, shpesh, herë të tjera, për të ruajtur fuqinë bindëse të ligjërit të vet. Kurse morali popullor tradicional po aq me ngulm konsideron si të virtutshme “mbajtjen e fjalës së dhënë”, “mos ndryshimin”, “ruajtjen e besës”. Deri në njëfarë kuptimi ka edhe të drejtë, sepse kështu mbrohet nga sharlatanët, por deri në cilët kufij? Ku do ta dallojnë këtë, nisur nga ky standard moral universal, nëse kemi të bëjmë me sharlatanin që manipulon pa skrupull me anë të komunikimit të tij politik apo kemi politikanin e shkathët që pa u ngurtësuar nga asnjë dogmë, i jep jetë dhe vitalitet nëpërmjet risive përmbajtjes politike të mesazheve që i adreson qytetit? Vetë standardi moral universal në fjalë nuk na bëjnë këtë gjykim që do të dallonte të virtutshmen nga vesi. Një nga specialistët më të mirë të komunikimit politik, Jacques Ellul, shkruan në librin e tij *L’Illusion Politique*: “Ne e dimë mirë se programi i një partie politike nuk e lidh atë me asnjë detyrim. Mund të bëhen premtime, mund të jepet fjala për diçka, mund të nënshkruhen afishe sa të duash: nesër gjithçka

harrohet, nesër vetëm disa njerëz me karakter të ashpër do të ishin aq të pakëndshëm sa t'i përmendnin këto formula. Në fakt, këtu nuk bëhet fjalë veçse për spërdredhje. Ndaj atyre që rrezikojnë ta qortojnë atë që ndodh, njihet përgjigja që u jepet, është e gjetur bukur. “Si? Po mendimin e harruat ju? Po lëvizjen? Ju e ndaloni dikë që të ndryshojë? Po koha? Si? Dëshironi të mbeteni rob i atyre që keni thënë dje?”

6. Moraliteti i brendshëm dhe i jashtëm

Mbi këtë bazë pikërisht janë përpunuar dy kategori thelbësore sikurse janë ajo e “moralitetit të brendshëm” dhe e “moralitetit të jashtëm”. Duket qysh në fillim se moraliteti i brendshëm është një koncept që pa i shkërmoqur parimet universale të moralit, synon që t'u gjejë atyre, zbatim konkret sipas fushave specifike të veprimtarisë njerëzore, ta zëmë, ndryshe në fushën e jurisprudencës, ndryshe në atë të politikës dhe ndryshe në atë të komunikimit. Moraliteti kështu merr kuptim vetëm brenda kufijve të një fushe të veçantë praktikash institucionale apo të aktorëve veprues. Brenda kësaj logjike, moraliteti i përgjithshëm magjik zëvendësohet në mënyrë funksionale me atë që shpesh quhet si deontologji e fushës. Pa iu larguar kuptimit të moralit si reflektim mbi vlerat e mira njerëzore në dallim nga veset, që ndan të mirën nga e keqja në sjelljen dhe jetën e njeriut, nëpërmjet kodesh e normash, e gjitha kjo shihet në lidhje të ngushtë me specifikat e shprehjes së saj në fusha të veçanta.

Edhe kur Jozeph Raz kërkon të gjejë moralitetin e politikës, pra, në fakt, atë që përbën përmbajtjen e komunikimit politik, kur dëshiron të gjejë kriteret ndarëse dhe vlerësuese në planin etik për të dalluar një politikë të mirë nga një politikë e keqe, edhe ai ka gjetur zgjidhje jo te një moralitet magjik universal apo popullor, të njëjtë për të gjitha llojet e veprimtarive njerëzore. Më shumë është prirë që zgjidhjen ta gjejë te një moralitet i brendshëm i politikës si veprimtari e lirë njerëzore për të administruar pushtetin dhe shtetin. Më shumë shkon përkrah zgjidhja që e zëvendëson konceptin e moralitetit magjik universal me anë të një deontologjie të brendshme për politikën. Politika e vërtetë është një mekanizëm lirë, përndryshe nuk është më një politikë, por bëhet sundim autoritarist. Prandaj, thelbi i çdo politike, cilado qoftë ajo, duhet të respektojë vlerat e lirisë njerëzore. Për Raz: “Tre tipare të rëndësishme e karakterizojnë doktrinën e lirisë të bazuar te autonomia. Së pari, kryesorja, është mbështetja dhe mbrojtja e lirisë pozitive, e cila kuptohet si një aftësi për autonomi, çka qëndron në mundësinë për një radhë zgjidhjesh të përshtatshme dhe aftësish mendore të domosdoshme për një jetë autonome. Së dyti, shteti ka detyrimin jo vetëm ta shmangë mohimin e lirisë, por edhe ta mbështesë atë duke krijuar kushtet për autonomi. Së treti, nuk duhet të kërkohen të realizohen qëllime nëpërmjet mjetesh të cilat godasin autonominë e qytetarëve me përjashtim të rasteve kur këto veprime janë të justifikuara nga nevoja për të mbrojtur dhe mbështetur autonominë e këtyre qytetarëve apo të tjerëve”.

Bibliografia

Adela Halo, Karakteristika të ligjërimit politik në Shqipëri, 24 Janar, 2013, <http://al.ejo-online.eu/> (qaur me 11.01.2015)

Fuga, Iqja nga kompleksi i Rozafës, 25.

Irida Vorpsi, Rhetorik und Kommunikation in der Albanischen Politik, Individuelles Masterstudium: Global Studies – a European Perspective, Wien, 2009

Fuga: Brirët e Dhisë, 435

Sitografia

<http://al.ejo-online.eu/1200/politika-e-medias/karakteristika-te-ligjerimit-politik-ne-shqipëri>

Fjala e Ilir Metës mbajtur në Shkodër 03.03.2009 <http://www.24-ore.com/mobile/politika/2720.html>

<http://www.youtube.com/watch?v=fD7LZcbI-D8>

<http://peizazhe.com/2014/04/07/sharja-ne-politike/>

<https://randodevole.wordpress.com/2014/04/13/sharja-ne-politike-ii/>

E DREJTA PËR VETËVEDOSJE E SHQIPTARËVË TË KOSOVËS NË KOHËN E SHPËRBËRJES SË ISH RSFJ-së

ERJONA RAMA

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti: Shkenca Sociale, Profili: Marrëdhënie Ndërkombëtare

ABSTRAKT

Koha që jetojmë dhe ky punim lidhen ngushtë me gjendjen juridike dhe politike në Kosovë e më gjerë dhe shprehin interesimin e veçantë për çdo qytetarë dhe më gjerë, qoftë ata që merren me shkencë, politikë, art apo tjetër. Tema e përcaktuar në këtë punim paraqet një çështje e cila kalon sferën e trajtimit të plotë si çështje të sovranitetit të brendshëm dhe bëhet si çështje thjeshtë me përmasa ndërkombëtare me ndikim të veçantë në rajon. Edhe trajtimi i sotëm, organizimi dhe pjesëmarrja e studiuesve dhe personaliteteve mendimi i të cilëve ka ndikim në këtë çështje tregon përkushtimin e tyre dhe motivon për një mendim të thellë dhe të argumentuar që për bazë ka vlerat shkencore të pranueshme jo vetëm për popullin shumicë të Kosovës por edhe bashkësinë ndërkombëtare që në këtë rast puthiten. Shpërbërja e ish Jugosllavisë ishte një ndër proceset më të mëdha dhe më të vështira në Evropë pas Luftës së Ftohtë. Një pjesë e procesit të shpërbërjes përfundojë me Marrëveshjen e Paqes në Dejton, por pjesa tjetër më e vështira, Kosova mbeti një kohë të gjatë pa u zgjidhur. Kosova ishte problemi i parë në ish Jugosllavi, por i neglizhuar kohë të gjatë. Situata në Kosovë, veçanërisht viteve të fundit, nuk ishte një problem i madh shqiptaro-serb por edhe ndërkombëtarë. Kosova në vitin 1999 ishte problemi më i madh në arenën ndërkombëtare, ndër më të mëdhenjtë pas Luftës së Dytë Botërore dhe test i bashkësisë ndërkombëtare në zgjidhjen e problemeve pas Luftës së Ftohtë. Qëllimi i këtij punimi është të jepet një pasqyrë e shkurtër mbi Kosovën, popullin e saj dhe rrënjët e këtij problemi. Në veçanti është synuar të elaborohet mbi të drejtën për vetëvendosje të popullit shqiptarë të Kosovës sipas standardeve ndërkombëtare nga aspekti legal, politik dhe të sigurisë. Analiza e shpërbërjes së ish Jugosllavisë ishte edhe arsyeja se ky ishte momenti shumë i përshtatshëm për shqiptarët e Kosovës për realizimin e aspiratave historike dhe orientimit të shqiptarëve dhe Kosovës nga perspektiva perëndimore. Shqyrtimi i të drejtës për vetëvendosje nga aspekti legal dhe ndërkombëtarë kishte trajtim të veçantë si mënyrë kryesore për arritjen e qëllimeve madhore. Ky trajtim është bazuar teorinë dhe praktiken ndërkombëtare mbi të drejtën për vetëvendosje të popujve në kohën e pas Luftës së Ftohtë dhe në kontekst me rastin e Kosovës. Me qëllim të argumentimit të plotë janë përdorur burime historike, legale, demokratike dhe demografike si dhe realiteti i krijuar në Kosovë. Trajtimi i kësaj të drejte nga aspekti i sigurisë kishte më shumë konotacion regional sepse shpeshherë është paraqitur pengese për njohjen e pavarësisë së Kosovës. Këtu janë dhënë argumente nga teoria, vetë jeta dhe historia e Kosovës dhe popullit shqiptarë se e kundërta do të destabilizonte rajonin dhe dyshimi nga destabilizimi i rajonit duket se historikisht ka marrë përgjigje negative. I gjithë punimi është një kontribut i vogël shkencor për të drejtën historike dhe legale të shqiptarëve dhe Kosovës për vetëvendosje dhe pavarësi.

Fjalë kyç: *Ish Jugosllavi, Kosovë, Siguria Rajonale, Pavarësi, Shpërbërje, Bashkësi Ndërkombëtarë, Vetëvendosje, Legalo-politike, Ballkan, Stabilitet, Konflikt, Gjeopolitik, etj*

Trajtimi i të drejtës për vetëvendosje të Kosovës në kohën e shpërbërjes së ish RSFJ-së

E drejta e vetëvendosjes kombëtare është njëra prej atraktiveve ngase ajo paraqet dy vlera, se pari njohjen e të drejtës së popujve të jetojnë sipas kulturës së tyre dhe është konsistente me kërkesat dhe synimet e parimeve të demokracisë.¹

Parimi i vetëvendosjes është një ndër parimet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare bashkëhore. Ky parim njëkohësisht paraqet një ndër parimet më të vështira për aplikim për çka bëhen orvatjet më të mëdha njerëzore dhe kombëtare. Ai është shkak i luftërave dhe paqeve në shumë rajone dhe për shumë vende e popujve.

Është parim që është ëndërruar shëkuq me radhe dhe ka ardhur në përdorim pas Luftës së Dytë Botërore dhe ka pësuar disa faza.

Deri në vitin 1989-1990 kjo e drejtë ka qenë njëra prej e kufizuar dhe është menduar se i takon vetëm vendeve nën kolonializëm. Kjo në një mënyrë ka rrjedh si interpretim i Deklaratës së vitit 1970 dhe jo i rrethanave praktike dhe teorike ngase edhe atëherë kanë ekzistuar mundësi dhe kërkesa për realizimin e kësaj të drejte fundamentale jashtë kontestit dhe vendeve koloniale.

Dështimi i komunizmit ka hupur mundësinë për zgjerimin e këtij parimi ndërkombëtare. Ai në mënyrë shumë të shpejte ka ndryshuar qasjen e tij por edhe mënyrën e realizimit. Është vërejtje një qasje e re ndaj vendeve që me parë ishin bashkuar me vullnet apo forcërisht në bashkësi shtetërore dhe tani sinonin pavarësimin. Është mundësuar ta realizojnë këtë të drejtë edhe ato vende që më kushtetutat e tyre nuk parashikonin një të drejtë të tillë. Në anën tjetër kjo e drejtë u realizua në mënyrë jo uniforme, sipas standardeve ndërkombëtare, por u var nga vendi, rrethanat dhe tensioni ndëretnik. Kështu disa shtete realizuan të drejtën për vetëvendosje në mënyrë të qetë dhe stabile, siç ishte rasti me ish Çekoslllovakinë, ndërsa të tjerat me dhunë të tmerrshme si në ish Bashkimin Sovjetik dhe veçanërisht në ish Jugosllavi.

Pas mbarimit të Luftës së Ftohtë bashkësia ndërkombëtare është përpjekur ti jap disa orientime mbi kushtet, mundësinë dhe mënyrën e realizimit të së drejtës për vetëvendosje. Parimi i vetëvendosjes ka qenë i interpretuar në mënyra të ndryshme, nga bashkësia ndërkombëtare si përgjigje ndaj shpërbërjes së shteteve komuniste. Kështu Unioni Evropian (në atë kohë Bashkësia Evropiane) ka qenë e para që është involvuar në këtë kontest. E drejta për vetëvendosje (shprehjes së vullnetit të lire) sipas Unionit Evropian është vlerësuar se i takon vetëm atyre që kanë jetuar brenda tipit federal të republikave. Etniteteve tjera iu është mohuar një e drejtë e tillë që do të nënkuptonte shprehjen e vullnetit të lire dhe krijimin e shtetit të vet. Ky qëndrim i Unionit Evropian është sanksionuar në mendimin e Komisionit Arbitrar të tij, të quajtur si Komiteti, i cili është themeluar në kuadër të Konferencës së Hagës mbi Jugosllavinë (Shtator 1991) dhe në Qëndrimin mbi Njohjen e Shteteve të Reja në Evropën Lindore dhe në Bashkimin Sovjetik të 1 dhjetorit 1991.²

Kështu e drejta për vetëvendosje deri në secesion iu është njohur atyre etniteteve të cilat në mënyrë të shprehur kanë gëzuar këtë të drejtë sipas kushtetutave të tyre siç ishte në disa raste (Bashkimin Sovjetik dhe Çekoslllovakinë) apo të tjerave që kanë gëzuar një status të avancuar (tipin e republikës) brenda federatave komuniste. Në këtë mënyrë është legjitimuar një, shpërbërje kushtetuese duke u bazuar tërësisht në interpretimin komunist të parimit të vetëvendosjes duke iu njohur kjo e drejtë atyre që me kritere komuniste i është njohur kjo e drejtë apo e kundërta.³

Në një mënyrë Unioni Evropian ka pranuar faktet e caktuara sipas modelit komunist në kushtetutat e tyre. Kjo vërehet në mendimin e parë të Komisionit të Badinterit të Nentorit të vitit 1991, ku thuhet: “Kushtetutat ishin fakti kryesor”.⁴

Duke u bazuar në këtë fakt janë legjitimuar disa koncepte legale-politike dhe dogmatike-kushtetuese lidhur me formën dhe mënyrën e përcaktimit komunist të zgjidhjeve të çështjeve kombëtare kur dihet se në ato sisteme (komuniste) Partia komuniste ka vendosur në mënyrë arbitrare se kush duhet të jetë republike, republike autonome apo etnitete federal, dhe kush komb, kombësi apo pakice kombëtare. Ngase dihet qartë se ideja e Stalinit dhe Leninit mbi tipin e klasave, që u takon e drejta për vetëvendosje ka dominuar në sistemet komuniste.⁵

Kosova fatkeqësisht para Luftës së Ftohtë ishte në kuadër të një shteti komunist. Si rrjedhojë e kësaj edhe në rastin shpërbërjes së ish Jugosllavisë dhe tendencës për fitimin e të drejtës për vetëvendosje u aplikuan masat komuniste të përcaktuara shumë vite më parë dhe larg realitetit dhe vullnetit të kosovareve. Nga këto konstatime të Unionit Evropian, të bazuar në ish Kushtetutën Jugosllave, rezultojë edhe mosnjohja e të drejtës së shqiptareve të Kosovës për vetëvendosje dhe pavarësi. Konstatimet e Unionit Evropian ishin baze për vlerësim edhe për shtetet dhe organizatat tjera ndërkombëtare.

Nga dokumentet e Unionit Evropian të asaj kohe shihet se aplikimi i këtij parimi është tentuar të jete në përputhje të plotë me të drejtën, demokracinë, të drejtat njerëzore dhe minoriteteve. Kështu ata propozuan që për ato etnitete që nuk u takonte e drejta për pavarësi, sipas tyre, tu përcaktohet një status special, ky ishte edhe propozimi për Kosovën.⁶

Michael Freeman: National Self determination, Peace and Human rights. Peace review Vol.10 No.2 June 1998.p.162.

Tekstin e plote mbi Mendimin e Komisionit të Badinterit mund të gjindet në :S.Trifunovska;Yugoslavia through documents... pp.415-418.474-481,634-640.

Cassese Antonio;Self-determination of peoples and the recent break-up to USSR and Yugoslavia.© by Kluwer Academic Publishers.1994. pp.134-141.

S.Trifunovska;Yug.through doc.p.415

Ibler Vladimir;Pravo naroda na samoodredjenje I zloupotreba tog prava.”Politicka misao”.Vol.XXIX No.2/92 Zagreb str.53-55.

Shih:Mendimet e Komisionit të Badinterit në vep.e cit.fq.422

Marrëdhëniet legale dhe politike në Kosovë në ish RSFJ-së

Pas ndarjes së kombit shqiptarë në vitin 1912-1913, jashtë shtetit të ri shqiptarë forcërisht janë detyruar të jetojnë së paku gjysma e kombit shqiptarë dhe gjysma e territoreve autoktone dhe të populluara me shumicë dërmuese me shqiptarë. Shqiptarët e Kosovës që nga ajo kohë ekzistojnë si komb i ndarë.

Që nga koha e ndarjes gjeopolitike të Kosovës nga Shqipëria, gjithmonë populli i Kosovës ka aspiruar për identitet të vetin, barazi apo për bashkim kombëtarë.

Gjatë gjithë kohës së qëndrimit të shqiptarëve nën ish Jugosllavi trajtimi i tyre ishte bërë si pakicë kombëtare, edhe pse ata qysh në themelimin e Mbretërisë Serbo-Kroate –Sllovene ata ishin numerikisht me shume se një nga themeluesit e kësaj mbretërie.⁷

Në kohën e pasluftës së Dytë Botërore, nën sistemin komunist të ish Jugosllavisë statusi juridiko-politik i Kosovës disa herë ka ndryshuar në forma të ndryshme të autonomisë politika-territoriale si në vitin 1946, 1963 dhe 1974. Në vitin 1974 është siguruar një autonomi e gjerë nga Beogradi me kompetenca të gjera dhe të ngjashme me ato të ish Republikave socialiste. Megjithatë e drejta për recesion nuk është garantuar ashtu siç nuk është garantuar as njësitë të tjera federale. Me Kushtetutën e vitit 1974 të ish RSF të Jugosllavisë ai shtet është konsideruar si shtet i përbashkët i kombeve dhe kombësive të barabarta, të republikave dhe krahinave autonome të Kosovës dhe Vojvodinës.⁸

Me Kushtetutën e vitit 1974 Kosova ka pasur identitetin e vet, territorin e vet (neni 5 I Kushtetutës) dhe në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare (neni 271 i Kushtetutës së RSFJ-së). Kosova ka lidhur dy tipe ndërkombëtare të marrëveshjeve në atë kohë një me RD të Gjermanisë dhe një me Bankën Botërore.⁹ Kosova është autorizuar të themeloje ‘Bankën Nacionale’ (neni 262) të mbledh taksat (neni 265) etj. Në shtim të këtyre zgjerimeve të kompetencave ishte edhe prezantimi i barabartë i Kosovës në të gjitha organet e Federatës përfshirë këtu edhe ish Presidencën Federale (neni 321).

Në kohën e rënies së komunizmit dhe shpërbërjes së ish RSF-së të Jugosllavisë Kosova filloi të ndërtojë identitetin e vet të ri. Në aspektin legal dhe politik ky identitet fillojë të ndërtohet me 2 Korrik të vitit 1990 kur Kuvendi i Kosovës nxori Deklaratën Kushtetuese e cila kërkonte që Kosova dhe popullata e kësaj shumice të trajtohen të barabartë me të tjerët në ish Jugosllavi.¹⁰ Në vazhdim të kësaj ishte edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës e miratuar me 7 shtator 1990 e cila ishte e bazuar mbi parimin e vetëvendosjes dhe barazisë sovraane.¹¹ Një vit më vonë prej 26-30 shtator 1991, me referendum, popullata shumicë e Kosovës, shqiptarët kanë ndërmarrë hapin më të madh në atë kohë në drejtim të vetëvendosjes dhe shprehjes së vullnetit të lirë.¹²

Në këtë kohë përveç këtyre akteve formale juridike të cilat me përjashtim të Shqipërisë nuk u njohën nga askush u ndërmorën edhe disa veprime nga përfaqësuesit legal të Kosovës në atë kohë në drejtim të ndërtimit të jetës së pavarur dhe njohjes ndërkombëtare të vullnetit tonë. Kështu ishte edhe kërkesa e Kosovës për njohje ndërkombëtare me 21 dhjetor 1991 disa dite pas që Bashkësia Evropiane kishte pranuar faktin se ish Jugosllavia ka pushuar të ekzistojë dhe se shtetet e reja duhet të aplikojnë për anëtarësi. Në këto kërkesa dhe tjerat të Kosovareve për pavarësi në fillim të viteve 90-ta nuk është dhënë përgjigje pozitive. Ekziston mendimi teorik se kjo mosnjohje ka ndodh si pasoje e mos përmbylljes së kriterit bazik ndërkombëtar për pavarësi, i cili është në kontrollin efektiv mbi territorin e Kosovës nga popullata shumicë dhe qeveria e tyre në kohën e shpërbërjes së ish Jugosllavisë.¹³

Kontrolli efektiv apo paaftësia për kontroll në një mënyrë është legjitimuar edhe në qëndrimet e Bashkësisë ndërkombëtare mbi shpërbërjen e ish Jugosllavisë. Ky qëndrim ishte bazuar jo shume në argumentet legale dhe morale por në ato gjeostrategjike dhe politike, në ndaljen e dhunës dhe shpërthimin e konfliktit në vendet fqinje.¹⁴

Bashkësia ndërkombëtare do të duhej marre parasysh ngritjen dhe rënien e ish Jugosllavisë, strukturën e saj dhe njësitë përbërëse të saj. Gjithashtu ish Jugosllavia ka pushuar se ekzistuar dhe kontinuiteti i tij nuk iu ka njohur asnjë republike, pra as të ashtuquajturit Jugosllavi të formuar në vitin 1992. Këtë fakt e kanë pohuar edhe mekanizmat ndërkombëtarë si OKB, UE dhe Banka Botërore siç e kemi cekur më parë. Një fakt me rëndësi në këtë krijese të re është se askush nuk e ka shpreh vullnetin e lirë përmes referendumit për bashkim apo hyrje në këtë shtet.

Shqiptarët e Kosovës nuk kanë marrë pjesë me asnjë akt juridik apo politik në strukturat dhe institucionet e Jugosllavisë së mbetur, ata qartë e kanë ndarë jetën, institucionet dhe ardhmërinë.

Kosova dhe populli shumicë i saj historikisht ka paraqitur një kolektivitet të veçantë etnik dhe gjuhësor. Ata kishin shtrirje kompakte territoriale. Pra kanë pasur territorin e vet kompakt dhe identitetin e qartë dhe të dukshëm kombëtar. Identiteti kombëtarë, kompaktësia territoriale dhe shumica absolute në Kosovë ishin veçori historike të shqiptarëve në këto troje.

Në aspektin konstitucional juridik pavarësia e Kosovës pas shpërbërjes së ish Jugosllavisë nuk paraqet prishje të kufijve, ngase Kosova kishte kufijtë e saj të pacenuar dhe të pranuar sipas akteve normative të ish Jugosllavisë.¹⁵

Shih: George Castelan; op. cit. p.49

Shih Preambulen e Kushtetutes së vitit 1974 të RSFJ-se dhe Nenet 1 dhe 5.

Tekstet e këtyre marrëveshjeve dhe aktet percjellese janë publikuar në Gazeten Zyrtare të Kosoves Nr.12/72;3/77 dhe 34/78.

Shih: Deklarata Kushtetuese, botuar në “Rilindje” dt.03.07.1990. fq. 1

Shih: Kushtetuta e Republikës së Kosoves e dt. 7 shtator 1990, botur në gazetën “Dielli”, Zagreb, 1990.

Shih Rezultatet e Referendumit të dt.26-30 shtator 1991 publikuar në gazetën ditore “Bujku” dt.01.10.1991. Prishtine. fq.1-3.

Collin Warbrick; Current developments; Public International Law. Recognition of the States. “International and Comparative Law Quartely”. Vol.41 Part 2 April 1992 p.480.

Marc Weller; The international response to the dissolution of the SFR of Yugoslavia. American Journal of International Law. Vol.86 No.

3 July 1992. pp.569-607.

Shih Kushtetuten e RSFJ-se të vitit 1974 dhe Kushtetuten e KSA të Kosoves të vitit 1974

Një fakt me rëndësi në këtë procedurë të realizimit të pavarësisë është edhe e dhëna se Kosova në vitin 1912 është aneksuar nga Serbia pas Luftërave Ballkanike në mënyrë të dhunshme, me okupim. Në Kosovë gjate 87 viteve të shkuara tretmani i Serbisë ndaj popullit shqiptarë ka qenë represiv dhe gjenocidal. Sidomos kjo është vërejtje në luftën e fundit të viteve 1998/99. E gjithë kjo i jap të drejtë dhe arsye Kosovës dhe popullit shqiptarë për pavarësi dhe sipas parimit të njohur ndërkombëtarë Serbia për nga trajtimi i saj i dhunshëm humbe të drejtën të qeverise me atë territor dhe atë popull.

Nga historia dihet se kombet i hyjnë ndarjes vetëm atëherë kur shtypja nacionale dhe fërkimet nacionale e bëjnë jetën e përbashkët absolutisht të padurueshme. Në këto raste mohimi i të drejtës për vetëvendosje dhe shkëputje të kombeve s'është gjë tjetër veç se përpjekje për mbrojtjen e privilegjeve të kombit sundues dhe metodave policore të udhëheqjes në vend të atyre demokratike¹⁶.

Kosova dhe populli i saj u mbajt me forcë nën juridiksionin Jugosllav, respektivisht Serb, në mungesë të forcës për çlirim dhe gatishmërisë së bashkësisë ndërkombëtare për përkrahje. Në momentin kur Kosova krijoi forcën për shkëputje dhe u rrit vullneti i bashkësisë ndërkombëtare për përkrahje ajo doli nga juridiksioni serb.

E drejta për vetëvendosje të një territori kompakt siç është Kosova dhe e populluar me mbi 90% të popullatës që dëshiron pavarësi jo vetëm që është e drejtë natyrore mbi bazën etnike por është edhe e drejtë demokratike dhe e përkrahur nga aktet pozitive ndërkombëtare. Insistimi i shqiptarëve të Kosovës për pavarësi është i bazuar në principin demokratik të shumicës dhe në qëndrimin e shqiptarëve me shume se mileniumi në ato troje.¹⁷

Populli shqiptarë i Kosovës në çdo mënyrë ka treguar vullnetin e tij për ndarje nga Serbia dhe jete të pavarur. Atë e ka shprehur në formë të ndryshme por në mënyrë me të zëshme me luftën e armatosur ku tregojë se dëshiron pavarësinë me gjithë sakrificat e mundshme ngase konsiderohej se jeta nën Serbi do të ishte sakrifice me e madhe.

Realiteti kombëtarë, demografik dhe territorial i popullit shqiptarë të Kosovës, individualiteti historik, gjeografik dhe struktura kombëtare e mbështetur në vullnetin e fortë demokratik dhe në parimin e barazisë dhe të drejtës së shprehjes së vullnetit të lire janë baza të arsyeshme që populli i Kosovës të ketë të drejtë për vetëvendosje dhe jete të lire dhe të pavarur. Mbi të gjitha është historia e ndare me lum gjaku në mes të këtyre dy popujve dhe asnjë e drejtë morale apo demokratike nuk do të mund të kërkonte që Kosova dhe shqiptarët ta përsërisin historinë e tyre të vrazhde dhe të përgjakshme. Çdo arsye e shëndoshe orienton nga perspektiva që është në përputhje me parimet e demokracive bashkëkohore dhe vullnetin e popullit të Kosovës dhe jo në kthim në vuajtje, tragjedi masakra dhe urrejtje tashme të provuar disa here gjatë historisë. Kthimi në atë pozite, juridiksionin serb, jo vetëm që do të nënkuptonte kthimin në ato tmerre të cekura por kësaj radhe do të përcillej me përgjegjësi të të kthyerve dhe atyre që përkrahin kthimin.

Një argument i madh për secesion është i bazuar edhe në faktin se populli i cili nuk dëshiron të përfshihet në një shtet të veçantë ka të drejtë morale të vendosë vetë për veten se a dëshiron të qëndrojë brenda kufijve të imponuar¹⁸.

Lufta për vetëvendosje dhe pavarësi nga aspekti i sigurisë në rajon

Lufta për vetëvendosje dhe pavarësi duhet të ketë parasysh edhe interesat e bashkësisë ndërkombëtare në ruajtjen e paqes dhe sigurisë dhe të drejtave tjera që dalin nga aktet e kombeve të Bashkuara. Kjo është edhe arsye e shtruarjes së kësaj çështje në kërkesën e shqiptarëve të Kosovës.

Sot dihet se çështja e Kosovës është çështje me tension të lartë mbi paqen dhe luftën në Ballkan dhe me gjerë. Pas disa viteve të status quos gjatë dy viteve të shkuara kriza e Kosovës ka hyrë në fazën me kritike, atë të luftës si pasoje e shume faktorëve. Kosova në vitet e fundit u bë çështje me rëndësi për sigurinë dhe stabilitetin e Ballkanit Jugor por edhe çështje me rëndësi për kredibilitetin për sigurinë Evropiane dhe të ardhmen e Aleancës veri-atlantike si mundësi për zgjerimin e konfiguracionit të konfliktit në Evropën Juglindore¹⁹.

Rëndësia e Kosovës për paqen dhe stabilitetin në rajon vërehet edhe nga pozita e saj gjeostrategjike e cila pothuaj edhe historikisht ishte prezente. Në fund të shekullit të kaluar gjeografi dhe etnologu serb Jovan Cvijic pati bërë një konkluzion duke vërejtur hartën e Gadishullit Ballkanik: "Kush zotëron Kosovën, kontrollon jo vetëm Serbinë, por edhe gjithë rajonin qendror të Ballkanit. Kemi të bëjmë me një nga pozitat me strategjike të Ballkanit".²⁰ Pikëpamjet e Cvijicit në rëndësinë e Kosovës në gjeopolitikën e Serbisë ndikuan në mënyrë përcaktuese në programet kombëtare serbe gjatë shekullit 19-te dhe me tutje.

Kriza e Kosovës në vitet e 90-ta ka marrë dimensionin ndërkombëtarë nga shume arsye. Këtë e pohojnë autore të huaj dhe vendor madje edhe ata serb. Sipas një autori serb Acimovic kjo ka ndodhur për arsye të të drejtave të njeriut dhe për arsye të mbrojtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.²¹

Në literaturë dhe në praktiken ndërkombëtare të viteve të pasluftës së Ftohtë është thënë se pavarësia e Kosovës do të rrezikonte paqen dhe sigurinë në rajon. Arsyetimet e shumta të mosnjohjes se të drejtës së Kosovës për vetëvendosje ishin të drejtuara nga ruajtja e stabilitetit në rajon në veçanti në rrezikimin e IRJ të Maqedonisë. Shikuar në aspektin formalo-juridik

Zejnullah Gruda; E drejta e vetëvendosjes së popujve. E Drejta Viti XXII Nr.2 Prill-Qershor 1996 Prishtinë fq.8.

Warren Zimmerman; The demons of Kosova..p.5.

Benjamin Neuberger; National and self-determination: Dilemmas of a concept; Nations and Nationalism. Vol.1 Part 3 November 1995.p.313

Jansuz Bugajski; Kosova between war and independence: Implication for international security. Tirana, February 1999 p.5-6.

Jorgo Samakos; Athina zbulon sekretin e luftes në Kosove. Gazeta "Fakti", 24 dhjetor 1998. Nr.219. Shkup fq.10.

Lubivoje Acimovic; Princip samoopredeljenja naroda I problem Kosova. Beograd 1998. str.6.

vetë përcaktimi i shqiptareve të Kosovës për shtet sovran dhe të pavarur në baze të rezultateve të Referendumit të vitit 1991 nuk lejon asnjë subjekt as individ të vendosë apo të kërkojë për ndonjë zgjidhje me shume se ajo e para. E njëjta vlen edhe për kërkesat më të vogla.

Edhe vetë lufta çlirimtare e popullit të Kosovës tregojë se u synua dhe u luftua për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran dhe jo për me shume apo me pak.

Lufta tregon më qartë se çdo gjë tjetër se Kosova rrezikon sigurinë dhe paqen nëse mbetet nën okupim dhe jo nëse pavarësohet.

“...nën hijen e ruajtjes së stabilitetit rajonal, mund të shtyhet për një kohë pavarësia e plotë e Kosovës, por vështirë se do të mund të eliminohet çështja e Kosovës në këtë drejtim si zgjidhje esencialisht demokratike dhe të balancuar në Ballkan. Prolongimi i saj nënkupton zgjatje të konfliktësish dhe tensioneve ndëretnikë në Ballkan”.²²

Zgjidhja afatgjate dhe stabile e çështjes së Kosovës nuk mund të lidhet vetëm me kufizimin e saj si “oaze të paqes”, por në gërshetimin e saj me drejtësinë. Paqja nuk ka kuptim pa drejtësi, ajo si e tillë është e imponuar dhe fragjile.

Populli shqiptar i Kosovës tani po kërkon vetëm të drejtën për të zënë vendin e vet që i takon në Ballkan dhe të jetojë i lire dhe në harmoni me fqinjët e tij.²³ Kjo çështje është e domosdoshme të depërtojë edhe në vetëdijen e popullit serb. Siç theksojnë shumë autore ndarja e Kosovës nga Serbia do të ndihmonte edhe vetë prosperimin dhe demokratizimin e Serbisë. Kur populli serb do të mendonte në mënyrë kritike dhe humane mbi Kosovën dhe mitin për të do të përfitonte jo vetëm populli i Kosovës por edhe ai i Serbisë.²⁴

Literatura shënon se në kohën e luftës 100 vjeçare ndërmjet Francës dhe Anglisë, Zhan Dark kishte thënë: “Për sa i përket paqes me anglezet, mënyra e vetme është që ata të kthehen mbrapa në vendin e tyre në Angli”.²⁵

Me të drejtën e popullit shqiptar të Kosovës për vetëvendosje përballë shteteve përreth dhe stabilitetit në rajon lidhet mendimi juridik: “*Qui iure suo utitur nemin facit iniuram*” (Ai që shfrytëzon të drejtën e tij nuk i sjell askujt padrejtësi).

Në drejtim të argumentimit të pavarësisë së Kosovës si faktor stabiliteti shkojnë edhe ngjarjet e fundit në Kosovë, lufta e ashpër për pavarësi, vuajtjet, masakrat, tragjeditë dhe vetë intervenimi i NATO-s ishte në këtë funksion. Andaj fitimi i pavarësisë së plotë do të nënkuptonte një territor dhe rajon të qete pa dhune dhe tragjedi dhe vetë misioni i NATO-s do të kishte satisfaksion dhe do të merrej si shembull për stabilitet të përjetshëm dhe mision humanitar të pakufizuar në kohë dhe qëllime abstrakte politike.

Në kontest të realizimit të së drejtës për vetëvendosje përballë stabilitetit rajonal po përmend fjalët e akademikut serb, Dobrica Qosiq, i cilësuar edhe si baba i kombit serb, ku thotë: vetëvendosja është parimi i parë i çfarëdo zgjidhje demokratike... derisa kjo të mos respektohet do të kemi luftë të gjatë dhe tragjedi të papara”.²⁶

Trajtimi i gjendjes ekzistuese dhe statusi final i Kosovës

Trajtimi i gjendjes ekzistuese të Kosovës kur gjendja juridike ndryshon me atë praktike është mëse i domosdoshëm edhe nga vetë fakti i trajtimit të së drejtës për të qenë shtet ngase në rastin e Kosovës, ngjashëm me shume vende tjera, dhe unikët me të drejtën ndërkombëtare, ushtrimi efektiv i pushtetit është i varur nga OKB dhe Institucionet e Përkohshme Vetëqeverise, dhe aspak nga shteti që formalisht ruan sovranitetin mbi këtë territor dhe këtë popullatë. Kjo trajtim behet ngase në planin ndërkombëtar realizimi i statusit legal dhe të drejtave legale shpesh kërkohet që të realizohen përmes materializimit të kërkesës. Në këtë aspekt, efektiviteti vepron në një masë si fakt për të treguar aftësinë për posedimin e së drejtës dhe që të plotësohen obligimet legale.

Efektiviteti i ushtrimit të pushtetit në një territor, mbi një popullatë ka ndikim në teorinë dhe praktiken ndërkombëtare. Disa autore që në fillimet e krijimit të shteteve moderne, i japin një rëndësi të madhe efektivitetit shpesh duke kërkuar që ai t’i paraprijë anës juridike apo edhe e parashohin kushte esenciale. kështu sipas Grocit kuptimi i efektivitetit luan një rol me rëndësi për stabilitetin në mes të subjekteve të së drejtës ndërkombëtare. Sipas Grocit përkatësia përcaktohet me efektivitet e kundërta do të thoshte diskutime pa fund.

Trajtimi i kësaj çështje në këtë mënyrë është pozitive për Kosovën në këtë rast ngase një gjendje e tillë vetëm ekziston por një gjë e tillë i ka edhe rreziqet e veta në kuptim të tendencave dhe stimulimeve për ndryshime të gjendjes faktike para asaj statusore apo edhe në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, duke tentuar ta venë të drejtën ndërkombëtare para aktit të kryer. Në fakt ndryshimi i gjendjes faktike për të cilën atribuohet në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat legale statusore dhe tjera mund të dërgojë të involvimi i përdorimit të forcës dhe shkeljes së të drejtës dhe sjell destabilizim. Por kjo nuk do të thotë se gjendja faktike duhet të respektohet para se të arrihen të drejtat statusore.²⁷ Pra ndryshime i gjendjes faktike duhet të bëhet mbi bazën e legjitimitetit të së drejtës për shtet të pavarur dhe Sovran sipas kritereve të së drejtës ndërkombëtare.

Në rastet ku ekziston e drejta për shtet të pavarur dhe Sovran, në kuptim të së drejtës ndërkombëtare dhe ekziston gjendja faktike në kuptim të ushtrimit të pushtetit efektiv po ashtu sipas kritereve ndërkombëtare, në rastin e Kosovës, njohja e

Gazmend Zajmi; Vep. e cit. fq. 180

Edit Durham; Brenga e Ballkanit. Tirane, 1991. fq. 426

Jansuz Bugajski; Kosova between war and independence... p.5; dhe Noel Malcolm; op.cit. p.356

CF. Bernard Josphe; Nationality-its nature and problems. ©George Allen, London 1990 p.190

Cituar sipas: Z. Gruda; E drejta e vetëvendosjes se popujve fq.18.

Darkop.53

gjendjes faktike do të ishte një veprim që do të plotësonte hendekun në mes të realitetit dhe të drejtës, mendim ky që përkrahët nga praktika dhe teoria ndërkombëtare.²⁸

E gjithë ky trajtim dhe ky arsyetim i gjendjes faktike në Kosovë nuk do të justifikonte këtë nëse do të arrihej sipas standardeve ndërkombëtare. Në teorinë ndërkombëtare haste mendimi se efektiviteti duhet të plotësojë disa kushte. e para, efektiviteti duhet të krijohet me të drejta dhe obligime sipas të drejtës ndërkombëtare, çka duhet të përkrahët edhe në rastin e Kosovës. Mundësia për plotësimin e këtyre kushteve në Kosovë është shumë e madhe kur të drejtat dhe obligimet janë pjesë e strukturës udhëheqëse por edhe një siguri e plotë ngase ushtrimin suprem të autoritetit në Kosovë e bën bashkësia ndërkombëtare, respektivisht OKB, pra mekanizmi ndërkombëtar që edhe kërkon që të plotësohen këto kushte .Pra, ai që kërkon plotësimin e kushteve dhe bën vlerësimin e tyre ka mundësi edhe të implementojë sipas kritereve të veta, që është rast i rrallë në botë,ndoshta me mandat më të plotë në botë.

Çështje diskutueshme është se a fitohet atributi i subjektit ndërkombëtare vetëm kur të arrihet efektiviteti i plote. Efektiviteti është një parakusht, kërkesë juridike për atributin e të drejtave sikur mund të jenë të drejtat statusore edhe pse ky parakusht nuk është I parapare me kriteret tradicionale për të qene shtet. Megjithatë efektiviteti si ne rastin e Kosovës krijon mundësi për të qenë e aftë në ushtrimin e aftësie për marrëdhënie ndërkombëtare si një kusht i të qenurit shtet ne kohët moderne.

Ne kuptimin e kritereve tradicionale e të qenurit shtet Kosova i plotëson të gjitha atributet. Dihet se kriteret tradicionale për të qenë shtet janë:!.Te këtë popullatën permanente, të këtë territorin, të ushtrojë Sovranitetit.²⁹dhe të këtë aftësi për të krijuar marrëdhënie ndërkombëtare. Këtu nuk kërkohet një popull i veçantë apo një minimum i numrit të popullatës apo të territorit. .Por kërkohen dy kushte, e para që të kenë qëllim të jetojnë permanent në atë territor, dhe e dyta, territor i kërkuar duhet të jetë i banueshëm. Për të gjithë tanimë është e qarte se qytetaret e Kosovës dëshirojnë të jetojnë ne mënyrë permanente dhe se territori i saj është i banueshëm.

Të qenurit shtet kërkon definim të territorit edhe pse jo gjithsesi të definuar ne kufijtë e jashtëm. Kosova këtu e plotëson ne tërësi këtë kushte kur dihet se gjate historisë se saj nen Serbi respektivisht ish Jugosllavi ka pasur territorin e vet, sidomos të definuar me Kushtetutën e vitit 1974 të ish RSFJ-se. ³⁰ Në këtë rast sipas teorisë dhe praktikës ndërkombëtare nuk kërkohet të jenë kufijtë të pakundërshtueshëm nga shtetet fqinje. Kështu ishte rasti me shume shtete pas luftës se I-re Botërore, apo edhe vete Shqipëria në kohën shpalljes dhe njohjes së pavarësisë Por kjo nuk do të thotë se nuk duhet që kufijtë e jashtëm nuk duhet të fiksohen ne kuptimin e asaj se për cilin territori bëhet fjala. ³¹ Në rastin e Kosovës është mëse e qartë që kërkesa e tyre është e definuar në kuptimin territorial, kjo është mese e qarte në kërkesat e tyre apo nëse merret ne kuptimin simbolik vërehet edhe në simbolet e tyre në institucione të pasluftës kur shihet harta e Kosovës.

Ushtrimi i sovranitetit është një nder kushtet e të qenurit shtet. Apo thënë ndryshe për të qenë shtet duhet të këtë Qeveri. Edhe pse nuk definohet saktësisht forma e qeverisë, dominon mendimi ne teorinë dhe praktiken ndërkombëtare, ajo duhet të jete në përputhje me të drejtën për vetëvendosje të popullit dhe ajo duhet të plotësojë dy kritere, e para të jete politikisht e institucionalizuar si makineri ekzekutive dhe administrative me qëllim të rregullimit të raporteve në shoqëri dhe e dyta, të jete qeveri efektive qe të ushtroje autoritetin shtetëror mbi territorin dhe popullatën.³² Në drejtim të plotësimit të këtij kushti dhe nën kushteve të saja, Kosova ka një Qeveri demokratike e zgjedhur nga qytetarët e saj, në zgjedhje të organizuara dhe të mbikëqyrura nga mekanizmat ndërkombëtare OSBE dhe OKB dhe Ke dhe mekanizmat tjerë. Po ashtu kjo Qeveri funksionon në bazë të akteve legale, Kornizës kushtetuese dhe ligjeve tjera të nxjerra nga organet legjislativë dhe të miratuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-se që autoritetin e vet e ushtron mbi bazën e këtyre akteve legale që janë sipas përputhjeve të standardeve ndërkombëtare dhe së bashku me mekanizmat ndërkombëtare me forcat e NATO-në aspektin e sigurisë, forcat policore të OKB-së në ruajtjen e rendit dhe qetësisë, me sistem juridik gjyqësor të kontrolluar nga UNMIK-u dhe me gjyqtar dhe prokuror ndërkombëtare po ashtu edhe me prezencë ndërkombëtare në çdo institucion të Kosovës.

Në kuptimin e ushtrimit të plotë të kompetencave Qeverisë së Kosovës mund të bëhet vërejtje se ajo është ende tutelën e OKB-se dhe se shumë kompetenca nuk i ushtron vetë por ato ushtrohen nga bashkësia ndërkombëtare. Mendoj se kjo është një bazë e mirë për krijimin e strukturës shtetërore dhe se ajo ndërtohet në tërësi me kriteret e njohura ndërkombëtare dhe se transferimi gradual i kompetencave do ta ndihmojë këtë ushtrim efektiv por edhe në përputhje me kriteret e kërkuara ndërkombëtare. Kjo nuk është ndonjë pengese pasi në të drejtën ndërkombëtare bashkëkohore qeveria si element konstituiv për të qenë shtet duhet të shihet si lloje i strukturës politike koherente e bazuar ne titullin legjitim qe të ushtroje autoritetin mbi territori dhe popullatë dhe jo domosdo si kriter për ekzistimin e administratës së sofistikuar dhe ushtrimit të plote të territorit të shtetit dhe banoreve të tij.³³

Një kusht tjetër në kohët moderne është edhe aftësia për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare. Në kuptim të plotësimit të këtij kushti nëse shikohet ana faktike Kosovës mund të bëhet vërejtje se nuk ka krijuar marrëdhënie ndërkombëtare, thënë ndryshe nuk ka hapur përfaqësi diplomatike. Çështja e parë është se sipas akteve legale ekzistuese të drejtën për të krijuar marrëdhënie ndërkombëtare e kanë kompetence në tërësi përfaqësuesit e OKB-se dhe se edhe tendencat për të bërë diçka në këtë drejtim janë penguar. Mirëpo, ne duhet të përkrahim mendimin qe dominon ne teorinë e të drejtës ndërkombëtare

Po aty,p.54

. Openheim,International law,1955 p.118

Shih Kushtetuten e RSFJ-se neni

(M.N.Shaw, Territory in International Law,NYIL Vol.13 1982 p.61

Openheim vep. E cit.p.118

Shaw,Inrtl.p.141

që është ngjashëm edhe me rastin e Kosovës, se kjo kërkesë nuk mund të shtrohet si e domosdoshme në kuptimin e pasjes së marrëdhënieve me shtete tjera pasi kjo varet edhe nga shtetet ekzistues por këtu kërkohet të jetë një makineri e cila është e aftë dhe e autorizuar që në mënyrë legale të lidh marrëveshje që të përfaqësojë shtetin me shtete dhe subjektet tjera të marrëdhënieve ndërkombëtare.³⁴ Nëse shihet gjendja strukturore në Kosovë nuk ka asnjë dilemë që Kosova është e gatshme të krijojë një makineri të aftë e cila do të ushtrojë autorizimet në kuptim të ndërtimit të marrëdhënieve ndërkombëtare me shtetet dhe subjektet tjera ndërkombëtare.

E gjithë kjo që u tha është një procedure normale sipas teorisë dhe praktikës ndërkombëtare mbi njohjen e shteteve të reja edhe pse në praktikën ndërkombëtare kemi edhe raste jashtë këtyre kritereve sidomos atij të efektivitetit. Kështu ka shtete që janë njohur edhe pa i plotësuar kushtet e efektivitetit të plotë apo plotësimin të këtyre kushteve siç është edhe rasti me Kroacinë, Gjeorgjinë etj. por vetë njohja ndërkombëtare si shtet iu ka mundur të ushtrojë kontrollin efektiv në territorin e tyre derisa Kosova do të bëhet e këtë nëse do të njihet para vitit 1998 në kohën e deklarimeve formale për shtet të pavarur dhe Sovran, ndërsa pas ndërhyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë ushtrimi efektiv i kontrollit nga Serbia është ndërprerë dhe tanimë gjendja ka kaluar në ushtrimin efektiv nga bashkësia ndërkombëtare dhe përfaqësuesit e Kosovës.

Rasti i Kosovës do të përputhet në tërësi me mendimin e teorianëve se pavarësia formale dhe aktuale. duhet të jetë e dyanshme³⁵. Nëse do të përkrahej mendimi që dominon sipas konstitutiveve dhe deklarativeve se formimi i shteteve është çështje faktike dhe jo e se drejtës.³⁶ Atëherë çështja e njohjes së Kosovës është një akt vijues që duhet të ndodh pas që ana faktike tanimë është plotësisht e qartë dhe atë nëpërmes ndihmës direkte të bashkësisë ndërkombëtare.

Por nuk duhet neglizhuar njohjen e pavarësisë ngase proklamimi i pavarësisë është një akt që thërret për njohjen dhe në të shumtën e rasteve njohja garanton një shkallë universale. Pra, etniteti legal është shtet por pa efekt legal dhe kështu nuk është shtet në kuadër të së drejtës ndërkombëtare që është kusht i domosdoshëm për funksionim normal të një shteti në kohën e interdependencave dhe globalizimit.³⁷

Nëse analizohen kërkesat për plotësimin e kritereve mbi bazën e efektivitetit, kriteret tradicionale dhe plotësimi i kritereve legale dhe ato moderne mund të themi se Kosova i plotëson në tërësi këto kritere.

Në kohën posmoderne janë vërejtur disa raste të mosnjohjes se disa kërkesave për shtet përkundër efektivitetit të plote territorial mbi bazën e krijimit të këtij efektiviteti dhe krijimit mbi baze ilegale. Kështu është rasti edhe me Kosovën që në një mënyrë është presedan për teorinë dhe praktikën ndërkombëtare apo thënë më drejtë një mosrespektim i traditës së njohjes së shteteve dhe vetë të drejtës ndërkombëtare.

Në kohën e shpërbërjes së ish Jugosllavisë respektivisht rënies së komunizmit, nga bashkësia ndërkombëtare një nder kushtet për njohje të shteteve të reja është venë edhe respektimi i të drejtave të minoriteteve. Të drejtat e minoriteteve në kohën moderne shihen si norma jus cogens. Kjo nuk ka ndodhur në kohën e njohjes së ish RFJ-së në vitin 1996, por në mënyrë faktike po ndodh në Kosovë. Nëse analizohen aktet legale në Kosovë mund të vërehen se në tërësi, përfshirë edhe diskriminimin pozitiv, minoritetet njihen me të gjitha të drejtat, shpesh si ato të shumicës përfshirë gjuhën, përfaqësimin, kulturën, shkollimin etj. Kjo ka ndodh edhe në ligjet e aprovuara nga organet e Kosovës por edhe nga kërkesat e bashkësisë ndërkombëtare ku të drejtën e rezervuar për të drejtat e minoriteteve e mban PSSP.³⁸ Njëkohësisht vlen të theksohet se në Kornizën Kushtetuese janë inkuorporuar edhe shumë konventa ndërkombëtare përfshirë edhe atë për të drejtat e minoriteteve.

Njohja e të drejtës për vetëvendosje është një lidhje e ligjshme me të drejtën për të qene shtet. Vetëvendosja politike në të gjitha situatat është *conditio sine qua non* për ushtrimin efektiv, mbrojtjen, zhvillimin dhe gëzimin e vetëvendosjes ekonomike, sociale dhe kulturore.³⁹ Njohja e të drejtës për vetëvendosje e kompenson mungesën e efektivitetit të plote dhe ndikon në të qenurit shtet në të drejtën ndërkombëtare. Kjo nuk është vetëm parim legjitim për të qenë shtet por mund të konsiderohet edhe si kriter modern për të qenë shtet. Njohja e shteteve, në këtë rast e Kosovës si shtet Sovran dhe I pavarur, përveç që ka karakter deklarativ a njëkohësisht ka edhe rol funksional. Se pari, E drejta për vetëvendosje të jashtme është bërë kusht dhe parim i legjitimitetit për shtet dhe krijimin e shtetit sipas të drejtës ndërkombëtare bashkëkohore, dhe e dyta, e drejta e brendshme për vetëvendosje i obligon shtete që të kenë prezantim dhe qeveri jo diskriminuese dhe kështu ka efekt në strukturat politike. Pra njohja e se drejtës për vetëvendosje të qytetareve të Kosovës do të ndihmonte që Kosova të ketë legjitimitetin e shtetit dhe të funksionojë si subjekt i barabartë në bashkësinë ndërkombëtare dhe do të stimulonte për një të drejtë për vetëvendosje të brendshme për shtet të barabartë dhe demokratik që do të bartte këtë subjektivitet në masë të njëjtë në botën moderne.

Përfundime

Kosova gjate kohës së Luftës së Ftohtë ishte nën një shtet komunist. Sipas kësaj edhe vullneti i popullit të Kosovës për vetëvendosje është përcaktuar sipas standardeve komuniste. Një kohë të gjatë Kosova nuk mund të realizonte të drejtën për vetëvendosje në mungesë të forcës për kontroll efektiv të kufijve të vet.

Shaw, Irtl, p.142

Crawford, Creation of the State pp.65-71

Oppenheim vep. E cit.p.544 Chen, Recognition, pp.38 and 60 etc.

Dugard, Recognition, p.147)

Shih nenin 8 të Kornizës Kushtetuese për vetëqeverisjen e perkoshme në Kosovë. Nder tjera theksohet se të gjitha ligjet duhet të respektojnë të drejtat e minoriteteve.

J.Klabbers and R.Lefebber, Africa: Lost Between Uti Posidetis and Self-Determination p.37-42.)

Zgjidhja afatgjatë dhe stabile e çështjes së Kosovës nuk mund të lidhet vetëm me kufizimin e saj si “oaze të paqes”, por në gërshetimin e saj me drejtësinë. Paqja nuk ka kuptim pa drejtësi, ajo si e tillë është e imponuar dhe fragile.

Populli shqiptarë i Kosovës tani po kërkon vetëm të drejtën për të zënë vendin e vet që i takon në Ballkan dhe të jetojë i lirë dhe në harmoni me fqinjët e tij. Kjo çështje është e domosdoshme të depërtojë edhe në vetëdijen e popullit serb. Siç theksojnë shumë autorë ndarja e Kosovës nga Serbia do të ndihmonte edhe vetë prosperimin dhe demokratizimin e Serbisë. Kur populli serb do të mendonte në mënyrë kritike dhe humane mbi Kosovën dhe mitin për të do të përfitonte jo vetëm populli i Kosovës por edhe ai i Serbisë.

Me të drejtën e popullit shqiptar të Kosovës për vetëvendosje përballë shteteve përreth dhe stabilitetit në rajon lidhet mendimi juridik: “*Qui iure suo utitur nemin facit iniuram*” (Ai që shfrytëzon të drejtën e tij nuk i sjell askujt padrejtësi).

Në drejtim të argumentimit të pavarësisë së Kosovës si faktor stabiliteti shkojnë edhe ngjarjet e fundit në Kosovë, lufta e ashpër për pavarësi, vuajtjet, masakrat, tragjeditë dhe vete intervenimi i NATO-s ishte në këtë funksion. Andaj fitimi i pavarësisë së plotë do të nënkuptonte një territor dhe rajon të qete pa dhune dhe tragjedi dhe vete misioni i NATO-s do të kishte satisfaksion dhe do të merrej si shembull për stabilitet të përgjeshëm dhe mision humanitar të pakufizuar në kohë dhe qëllime abstrakte politike.

Me mbarimin e Luftës së ftohtë dy kushte janë plotësuar, roli i Bashkimit Sovjetik në Evropën Qendrore dhe Lindore dukshëm është zvogëluar, roli i RF të Gjermanisë është rritur dukshëm ndoshta jo në ndryshimin e gjërave por sidomos në ruajtjen e *status quos*. Për herë të parë të dy vendet janë venë në pozitë që të mos shohin zgjidhjen e problemeve përmes forcës ushtarake jashtë kufijve të tyre nacional. Këto ndryshime janë shumë me rëndësi që kanë ndikim në ndryshimet e tjera fundamentale por edhe në tërësi në marrëdhëniet ndërkombëtare në Evropë që lidhet me integrimet substanciale ekonomike të Evropës Perëndimore dhe në të gjitha sferat tjera duke rritur njëkohësisht asociimin e ngushtë me ekonomitë liberale në Lindje. Këto dhe ndryshimet tjera i kanë bërë të vështira apo edhe të pamundura udhëheqjet hegjemoniste mbi popujt dhe vendet tjera, pra duke i shmangur gati në tërësi konfliktet dhe antagonizmat etnik në mes të fuqive të mëdha evropiane por edhe të tjera.

Kjo tregon një analizë dhe perceptim të ri është se në Evropë ka ardhur një erë e cila është kualitativisht ndryshe nga e kaluara e njohur që nënkupton se politika ndërkombëtare e kaluar nuk është e shfrytëzueshme për të tashmen apo parashikimin e zgjidhjeve në të ardhmen. Këtë e thashë që të kuptojmë se e ardhmja është me ndryshe si në analizat akademike por edhe ato politike në çdo rast edhe në atë të Kosovës.

Natyrisht një pjesë të rëndësishme ka edhe vete struktura e brendshme e shteteve individuale, se a do të jetë luftë apo paqe në konfliktet e interesave është me rëndësi a janë ato shtete diktatoriale apo demokratike dhe me pak se a kanë dhe sa kanë fuqi ushtarake.

Verifikimi dhe monitorimi nga forcat ndërkombëtare të paqes dhe sigurisë në regjion dhe në veçanti në Kosovë dhe IRJ të Maqedonisë është i domosdoshëm derisa të krijohet një situatë stabile në këto vende dhe të krijojnë mekanizma stabile për mbrojtje evituese në njërin anë dhe në anën tjetër derisa të hiqet nga skena politika hegjemoniste e vendeve që krijojnë kriza siç është Serbia, të hiqet miti dhe ndjenja për hegjemoni si dhe të demokratizohen deri në atë shkallë që janë në gjendje të njohin të drejtat edhe të tjerëve jo vetëm të vetat që nuk është gjë tjetër veçse nacionalizëm.

Anëtarësimi në UE është zgjidhje për ikje të konflikteve, aksione të përbashkëta për të mirat kolektive ekonomike dhe politike, si një përvojë e parë në shtetet fqinje të Evropës perëndimore pas Luftës së II botërore. Kjo e rrit besimin dhe si rezultat ka edhe sigurinë më të madhe.

Pranimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si parakusht për anëtarësim në KE, dhe akteve tjera bilaterale dhe multilaterale janë një kusht që do të relaksonte raportet dhe respektimi i tyre nga institucionet vendore jo vetëm që do të ishte bindje e tyre por edhe një lloj imponimi dhe arsytimi para forcave ekstremiste se duhet respektuar si pasoje e akteve ndërkombëtare, pra bartje e përgjegjësisë në institucionet ndërkombëtare dhe kontribut krijimin e opinionit me të përshtatshme për ta bërë këtë pjesë të vetëdijes dhe institucioneve nacionale.

Pavarësia e Kosovës sikur pavarësia e Shqipërisë që nuk ka ndikuar për mëse ‘90 vite në destabilizimin e rajonit do të ishte e njëjtë por të thënë se ndoshta do të relaksonte raportet e shqiptareve me të tjerët duke pasur si satisfaksion këtë dhe ndonjë në e kompromisit se gjendja e tyre është në favor. Shpeshherë qëndrimet dhe veprimet e shtetit “ame” kanë qene me afër kompromisit se vet popujt që kanë kërkuar apo luftuar për të drejtat e tyre.

Balancë në rajon do të krijohej me këtë sidomos në mes të shqiptareve dhe serbëve, por edhe kroateve që në një mënyrë janë faktor për ruajtjen apo prishjen e paqes në rajon. Praktikata e deritanishme kanë treguar se vetëm forcat e balancuara kanë krijuar paqen nga ndjenja e barazisë dhe deterrence në mes tyre por edhe kundërvënies në raste që njëra nga forcat e balancuara dëshiron të prish paqen. Kështu p.sh. do të ruhej IRJM nga Serbia apo Bosnja nga Shqiptarët e kështu me radhë pra do të krijohej simetri në rajon, dhe më të mëdhenjtë do të respektonin tjerët nga deterrence e balancuesit tjetër.

Mbajtja e paqes është më ndryshe se sa bërja e saj. Në afat të shkurtër zgjidhja e konflikteve dhe ruajtja e paqes do të jetë efektive vetëm nëse ato janë të mbështetura me ndihme ekonomike. Natyrisht konfliktet etnike në Evropën Lindore kanë rrënjë të thella por ana ekonomike se paku do të relaksojë ato. Kjo do të ishte një përkrahje për paqen stabile por edhe për mbrojtjen dhe zhvillimin e demokracive liberale të ish bllokut të Varshavës. Ndihma për shtetet e varfra do të jetë njëkohësisht, një ngushtim i politikës së jashtme militare të shteteve të mëdha.

Me qëllim të krijimit edhe të mendimit të balancuar në këtë konflikt etnik dhe territorial në mes të dy popujve, tij e shqiptarë dhe serb po parafrazoje dy akademik nga të dy popujt.

Në kontest realizimit të se drejtës për vetëvendosje përballë stabilitetit rajonal po përmend fjalët e akademikut serb, Dobrica

Qosiq, i cilësuar edhe si baba i kombit serb, ku thotë: “vetëvendosja është parimi i parë i çfarëdo zgjidhje demokratike... derisa

kjo te mos respektohet do te kemi lufte te gjate dhe tragjedi te papara”. Dua te besoj se kur e ka thënë këtë nuk ka menduar ne mënyrë jodemokratike vetëm për popullin e tij por si parim universal.

Po e theksoje konstatimin e prere te akademikut te ndjere Gazmend Zajmit karshi thënies për pavarësinë e Kosovës si faktor destabiliteti ku shprehet: “...nen hijen e ruajtjes se stabilitetit rajonal, mund të shtyhet për një kohe pavarësia e plotë e Kosovës, por vështirë se do te mund te eliminohet çështja e Kosovës në këtë drejtim si zgjidhje esencialisht demokratike dhe te balancuar në Ballkan. Prolongimi i saj nënkupton zgjatje të konfliktësisë dhe tensioneve ndërretnike në Ballkan”.

Njohja e të drejtës për vetëvendosje është një lidhje e ligjshme me te drejtën për të qenë shtet. Vetëvendosja politike në të gjitha situatat është *conditio sine qua non* për ushtrimin efektiv, mbrojtjen, zhvillimin dhe gëzimin e vetëvendosjes ekonomike, sociale dhe kulturore. Njohja e te drejtës për vetëvendosje e kompenson mungesën e efektivitetit të plotë dhe ndikon në të qenurit shtet në të drejtën ndërkombëtare. Kjo nuk është vetëm parim legjitim për të qenë shtet por mund të konsiderohet edhe si kriter modern për të qenë shtet.

Njohja e se drejtës për vetëvendosje të qytetareve të Kosovës do të ndihmonte që Kosova të ketë legjitimitetin e shtetit dhe të funksionojë si subjekt i barabartë në bashkësinë ndërkombëtare dhe do të stimulonte për një të drejtë për vetëvendosje të brendshme për shtet të barabartë dhe demokratik që do të barte këtë subjektivitet në masë të njëjtë në botën moderne. Argumente të mëdha legale, politike, strategjike dhe të sigurisë janë në favor të vetëvendosjes së shqiptarëve dhe Kosovës. E drejta për vetëvendosje të shqiptarëve dhe Kosovës përputhet në tërësi me vullnetin e lire të popullit shumicë dhe në pajtueshmëri me parimet demokratike, në dobi të paqes dhe stabilitetit në rajon. Një burim të veçantë kjo e drejtë e ka në të drejtën morale të popullit të Kosovës dhe në humbjen e kësaj nga regjimi serb pas gjithë asaj dhune të shfrenuar nga regjimi okupues serb për vite me radhë dhe të vrazhdësuar në vitet e fundit. Vetëvendosja për popullin e Kosovës do të ishte plotësim i një të drejte natyrore, historike, demografike, legale, demokratike dhe mbi të gjitha satisfaksion për vuajtjet shekullore të këtij vendi dhe këtij populli dhe ndërtimi i perspektives për ata dhe gjithë regionin.

Bibliografia

- Aleksander Stipcevic; "The Question of Illyrian-Albanian Continuity and its Topically Today". "Kosova". No.4. Tiranë. 1994.
- Ratko Katicic; "Ancient Languages of the Balkans". The Hague-Paris, 1976
- George Castellan; "History of the Balkan". London 1997.
- Vladimir Dedijer; "Jugoslavia od Versaja do Pariza", Beograd 1947.
- Z. Gruda; "E drejta për vetëvendosje e popujve". "E drejta". Viti XXII Nr.2. Prill-Qershor 1996.
- Prishtine N. Molcolm; "Kosova një histori e shkurtër", Prishtinë, 2001
- Darko Sekulic; "The creation and disollution of the multinational state: the case of Yugoslavia." "Nations and Nationalism". Vol.3 Part 2 July 1997
- Lord Owen; "The break up of Yugoslavia: its international aspects." "International Peacekeeping". Vol.3 No.2-3 February-May 1996.
- Vesna Godina; "The outbreak of natuionalism on fortmer Yugoslavia. A historical problem of supranational identity." "Nations and Nationalism". Vol./4. Part.3 July 1998.
- Snezana Trifunovska; "Preventive Peacekeeping and the case of FYROM." "International Peacekeeping" Vol.4 No.1-2. Januar-december 1997. Gazmend Zajmi; Vepra 1. AASHK, Prishtinë. 1997
- Mark Almont "Europe backyard war". London.
- Jansuz Bugajski; "Nations in Turmoil. Conflict and Cooperation in Eastern Europe." © Westview Press inc. 1993
- David E. Goodlett; "History and Nationality among former Yugoslavs." "European Security". Vol.6 No.2 summer 1997
- Eduard R. Ricciuti; "War in Jugosllavia. The breakup of a nation." © by Blackbrich Graphics
- Thomir Loza; "Kosovo Albanians: Closing the Ranks. Transitions" Vol.5 No.5 May 1998.
- James Gow; "Legitimacy and the military." Copyright © by J. Gow.
- Warren Zimmerman; "The Demons of Kosova/o. National interests." No.52 spring 1998
- Alan Fogelquist; "Handbook of Facts on the Break-up of Yugoslavia; International Policy and the War in Bosnia-Hertcegovina." © by A.F. 1993
- Rezoluta nr.777 e KS te OKB-së e aprovuar në takimin 3193 te KS te OKB-së më 19 shtator 1992. publikuar në internet: www.un.doc.
- S. Trifunovska; "Yugoslavia through documents"
- Michael Freeman; "National Self determination, Peace and Human rights." "Peace review" Vol.10 No.2 June 1998.
- Cassese Antonio; "Self-determination of peoples and the recent break-up to USSR and Yugoslavia." © by Kluwer Academic Publishers. 1994
- Ibler Vladimir; "Pravo naroda na samoodredjenje i zloupotreba tog prava." "Politicka misao". Vol. XXIX No.2/92
- Zagreb
- George Castelan "Mendimet e Komisionit të Badinterit në vep.e cit
- Preambulën e Kushtetutës së vitit 1974 te RSFJ-se dhe Nenet 1 dhe 5.
- Gazetën Zyrtare të Kosovës Nr.12/72;3/77 dhe 34/78.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës e dt.7 shtator 1990, botur në gazetën "Dielli". Zagreb, 1990
- Collin Warbrick; "Current developments; Public International Law. Recognition of the States." "International and Comparative Law Quartely". Vol.41 Part 2 April 1992
- Marc Weller; "The international response to the dissolution of the SFR of Yugoslavia." "American Jurnal of International Law". Vol.86 No. 3 July 1992.
- Kushtetutën e RSFJ-se te vitit 1974 dhe Kushtetutën e KSA te Kosoves te vitit 1974
- Zejnullah Gruda; "E drejta e vetëvendosjes së popujve." "E Drejta" Viti XXII Nr.2 Prill-Qershor 1996
- Prishtinë
- Warren Zimmerman; "The demons of Kosova."
- Benjamin Neuberger; "National and self-determination: Dilemas of a concept; Nations and Nationalism." Vol.1 Part 3 November 1995

Erjona Rama

Jansuz Bugajski; *Kosova between war and independence: Implication for international security*. Tirana, February 1999

Jorgo Samakos; *Athina zbulon sekretin e luftës në Kosovë*. Gazeta "Fakti", 24 dhjetor 1998. Nr. 219. Shkup

Lubivoje Acimovic; *Princip samoopredeljenja naroda I problem Kosova*. Beograd 1998

Edit Durham; *Brenga e Ballkanit*. Tiranë, 1991.

CF. Bernard Josphe; *Nationality-its nature and problems*. ©George Allen, London

1990 M.N. Shaw, *Territory in International Law*, NYIL Vol. 13 1982

TRANSNACIONALIZMI I VONUAR NË ZHVILLIMIN SHOQËROR DHE DEMOKRATIK NË BALLKAN DHE SHQIPËRI

JONIADA BARJABA

University of Sussex, Migration Studies

ABSTRAKT

Objekti i studimit kërkimor, të cilit do t'i referohem në këtë prezantim, është dinamika dhe tiparet e sipërmarrjes transnacionale midis emigrantëve dhe të kthyerve, të cilët janë duke bërë biznes në/me Shqipërinë. Studimi identifikon format e ndryshme të aktiviteteve ekonomike transnacionale të emigrantëve shqiptarë, motivet, marrëdhëniet dhe faktorët e tjerë që ndikojnë praktikën e tyre transnacionale. Studimi gjithashtu shqyrton rolin e veprimtarisë institucionale që lidhet me mbështetjen e sipërmarrjeve transnacionale në kontekstin e politikave të qeverisë shqiptare për menaxhimin e migracionit dhe vonesën e sipërmarrjes transnacionale në Ballkan dhe Shqipëri. Për nga natyra, Ballkani ofron një terren natyral për zhvillimin e transnacionalizmit. Popuj të etnive, kulturave, feve dhe gjuhëve të ndryshme jetojnë në territore të vogla dhe hapësira gjeografike të ngushta. Kjo është një arsye më shumë që duhet të imponojë bashkëjetesën paqësore dhe demokratike. Por, marrëdhëniet midis ballkanasve, edhe gjatë dekadave të fundit, kanë dështuar të jenë marrëdhënie ekonomike bashkëpunimi, në nivelin që janë në gadishujt dhe rajonet e tjera të Europës. Ballkani nuk është zhvilluar si një kantier ekonomik, por si një oficinë mosmarrëveshjes e konfliktesh. Kjo ka vonuar edhe zhvillimin e sipërmarrjeve transnacionale që gjenerojnë flukset migratore. Të cilat, nga ana e tyre, shkaktojnë vonesat në zhvillimin shoqëror dhe demokratik në rajon.

Fjalë kyç: *transnacionalizmi, sipërmarrja transnacionale, sipërmarrja etnike, migrimi*

1. Hyrje

Në shoqërinë bashkëkohore, teknologjia e re në telekomunikacion dhe transport dhe proceset multikulturale, po nxit zhvillimin e aktiviteteve ekonomike transnacionale. Sipërmarrja transnacionale po bëhet një aktivitet i rëndësishëm ekonomik në mbarë botën. Megjithatë, për shtrirjen dhe zhvillimin e sipërmarrjes transnacionale në Evropën Jugore dihet shumë pak. Shqipëria ka marrë shumë pak vëmendje në studimet mbi aktivitetet ekonomike transnacionale, përveç disa studimeve sporadike mbi remitancat. Një tjetër aspekt i rëndësishëm për t'u konsideruar është vonesa e sipërmarrjes transnacionale në Shqipëri. Prandaj, në analizën time adresoj boshllëkun në analizat dhe studimet për sipërmarrjen transnacionale në Shqipëri. Studimi shtrihet, përveçse në Shqipëri, edhe në Itali e Greqi, dy vendet më popullore pritëse të emigrantëve shqiptarë.

Prezantimi përbëhet nga pesë kapituj. Kapitulli i parë prezanton problemin. Kapitulli i dytë shqyrton literaturën mbi sipërmarrjen transnacionale. Kapitulli i tretë analizon disa nga pengesat për transnacionalizmin në Ballkan dhe Shqipëri. Kapitulli i katërt përshkruan pyetjet e kërkimit shkencor. Kapitulli i pestë fokusohet në metodologjinë e përdorur për kryerjen e studimit.

2. Shqyrtimi i literaturës

Gjatë dekadave të fundit, po përfshihen në aktivitete sipërmarrëse gjithnjë e më shumë emigrantë. Një pjesë e tyre krijojnë ndërmarje transnacionale. Për të kuptuar më mirë modelet e pjesëmarrjes së emigrantëve në sipërmarrjet transnacionale, duhet të shqyrtojmë sipërmarrjen etnike dhe transnacionalizmin. Prandaj ky kapitull shqyrton literaturën ekzistuese mbi këto koncepte. Pjesa e parë përshkruan teoritë që shpjegojnë zhvillimin historik dhe arsyet pse emigrantët përfshihen në biznes. Modelet e diskutuara janë: minoriteti ndërmjetës, ekonomia e enklavave, struktura e mundësive dhe vendosja e përzier. Pjesa e dytë fokusohet në përkufizimet, risinë, dimensionet dhe kushtet e transnacionalizmit. Pjesa e tretë shqyrton përkufizimet, proceset dhe llojet e sipërmarrjeve transnacionale.

2.1. Teoritë mbi sipërmarrjen etnike

Rritja e sipërmarrjeve etnike ka tërhequr vëmendjen e publikut që në fillim të viteve 1970-të (Kloosterman dhe Rath 2003) dhe ka stimuluar shumë kërkime shkencore. Sipërmarrësit etnikë shpesh referohen si pronarët dhe menaxherët (ose operatorët) e bizneseve të tyre. Anëtarësimi në grupet sipërmarrëse është i lidhur me trashëgiminë e përbashkët kulturore ose me origjinën e përbashkët (Zhou, 2004, f. 1040). Kërkuesit shkencor bazohen në koncepte të ndryshme për të analizuar motivet dhe dinamikën e sipërmarrjes etnike.

2.1.1 Teoria e minoritetit ndërmjetës

Teoria e minoritetit ndërmjetës supozon që sipërmarrësit emigrantë fillojnë aktivitetin në sektorë të caktuar të biznesit për të fituar të ardhura sa më shpejt. Minoritetit ndërmjetës i referohet sipërmarrësve etnikë që tregtojnë mes elitës së shoqërisë dhe një grupi me të ardhura më të ulta. Pra, janë të vendosur në “mes” të sistemit ekonomik. Ata fillojnë aktivitetin si emigrantë të përkohshëm që emigrojnë për të fituar të ardhura shpejt dhe pastaj të kthehen në atdhe (Bonacich, 1973). Ky supozim nuk duket të aplikohet plotësisht në shumicën e emigrantëve shqiptarë. Shumica e tyre kanë vendosur rrënjë dhe janë integruar në vendet pritëse.

2.1.2 Teoria e enklavave

Teoria e enklavave shpjegon pse emigrantët tërhiqen për vetëpunësim. Zakonisht, emigrantët, për shkak të vështirësive ekonomike, kualifikimeve të ulëta dhe diskriminimit, punësohen në tregun dytësor. Për shkak se tregu parësor nuk është i arritshëm dhe tregu dytësor ofron mundësi të kufizuara ekonomike, emigrantët themelojnë një enklavë etnike, e cila konsiderohet nga Wilson dhe Portes (1980) një sektor i veçantë ekonomik, i ndarë nga sektorët parësor dhe dytësor të tregut të punës. Portes (1981) argumenton se enklava etnike përbëhet nga grupe emigrantësh, të cilët përqendrohen në një hapësirë të veçantë dhe ngrenë biznese në shërbim të komunitetit emigrant brenda enklavës. Pra, enklava etnike është një mjedis i rëndësishëm për zhvillimin e bizneseve etnike. Në kundërshtim me teorinë mbi minoritetin ndërmjetës, teoria mbi enklavën etnike fokusohet në përqendrimin gjeografik të emigrantëve.

2.1.3 Teoria e strukturës së mundësive

Waldinger, Aldrich dhe Ward (1990) kanë zhvilluar një model më interaktiv për sipërmarrjen etnike. Sipas tyre, procesi i sipërmarrjes etnike është një bashkëveprim i faktorëve politikë-ekonomikë dhe social-kulturorë (Waldinger, Aldrich & Ward 1990, f. 31, 32). Ai përbëhet nga tre komponentë: struktura e mundësive, karakteristikat e grupit, dhe strategjitë etnike. Struktura e mundësive përbëhet nga kushtet e tregut (produkte të konsumit etnik dhe tregjeve jo-etnike/të hapur) dhe aksesit për pronësi (vendet e lira të biznesit, konkurrencës për vendet e lira, dhe politikat qeveritare). Karakteristikat e grupit përbëhen nga rrethanat e para-migrimit (aftësitë, gjuhët, përvoja në biznes, dhe qëndrimi sipërmarrës), rrethanat e migrimit (punëtorë të përkohshëm ose të përhershëm) dhe rrethanat e pas migrimit (pozita e një grupi të pakicës në ekonominë e vendit pritës). Aktiviteti ekonomik i emigrantëve është një pasojë interaktive e ndjekjes së mundësive nëpërmjet mobilizimit të burimeve etnike ose karakteristikave socio-kulturore të një grupi (Ligth & Bonaich 1988, f. 178).

2.1.4 Teoria e vendosjes së përzier

Kloosterman, van der Leun, dhe Rath (1999) përdorin një koncept më të plotë, vendosjen e përzier, që përfshin ndërveprimin mes konteksteve sociale, ekonomike dhe institucionale. “Në këtë pikëpamje, rritja e sipërmarrjes etnike është e vendosur, teorikisht, në kryqëzimin e ndryshimeve në kuadrin social-kulturor, nga njëra anë, dhe procesit të transformimit në ekonomitë (urbane) dhe kuadrin institucional në anën tjetër” (Kloosterman, van der Leun, dhe Rath, 1999, f. 8).

2.1.4.1 Teoria e rrjeteve sociale

Rrjetet sociale shërbejnë si mekanizma për sipërmarrjen. Portes (1995, f. 8) përkufizon rrjetet sociale si “mjedise të shoqatave të njerëzve të lidhur midis tyre nga marrëdhënie punësuese, familjare, kulturore dhe afektive” dhe i konsiderojnë ato struktura të rëndësishme, në të cilat ndodhin transaksionet ekonomike. Ai thekson rëndësinë e rrjeteve në jetën ekonomike, si “burime për blerjen e mallrave që gjenden me vështirësi... dhe që imponojnë kufizime në arritjen e fitimeve individuale”. Rrjetet sociale lehtësojnë aksesin e sipërmarrësve në burime dhe informacion. Kyle (1999) dhe Poros (2001) argumentojnë se individët me rrjete të gjera janë në një pozitë më të mirë për të filluar dhe zhvilluar sipërmarrjet transnacionale. Rrjetet organizative dhe ndërpersonale të emigrantëve i orientojnë ata drejt destinacioneve dhe punësimeve të caktuara. Ato ndihmojnë individët për të mobilizuar burimet për sipërmarrjet dhe për të shfrytëzuar më mirë mundësitë e tregut në vendet e pritëse e dërguese.

2.1.4.2 Teoria e kapitalit social

Kapitali social është gjithashtu një koncept i rëndësishëm në analizimin e aktiviteteve ekonomike transnacionale. Sipas Portes (1995), kapitali social është aftësia e individëve për të menaxhuar burimet e pakta të bazuara në rrjetet apo strukturat sociale. Fukuyama (1995) thekson se kapitali social është një faktor kyç në nxitjen e zhvillimit. Shumë faktorë të tjerë si teknologjia, kapitali njerëzor dhe tregu ndikojnë në performancën ekonomike. Megjithatë sipas Fukuyamës, kapitali social ka një ndikim të fuqishëm në rritjen ekonomike. Kapitali social është një faktor kyç edhe në shpjegimin e suksesit të emigrantëve në biznesin e tyre dhe aktivitetet ekonomike. Një studim i fundit i kryer në Shqipëri dhe Serbi (Pavlov, Despić, Milutinović, Balli, Zhebo, Barjaba & Zeneli, 2014) sugjerojnë një korrelacion të drejtpërdrejtë midis sasisë së kapitalit social që emigrantët kanë dhe suksesit të tyre në krijimin e rrjeteve dhe sipërmarrjeve transnacionale. Sa më i madh kapitali social që ata kanë, aq më të suksesshme e produktive janë aktivitetet e tyre transnacionale të sipërmarrjes.

2.2. Teoritë mbi transnacionalizmin

Koncepti i transnacionalizmit ka ofruar një perspektivë ndryshe në studimet mbi migrimim dhe ka ekspozuar disa karakteristika të reja të komuniteteve të emigrantëve në kontekstin global. Transnacionalizmi shpjegon pse dhe se si lidhjet sociale, politike dhe ekonomike të emigrantëve të sotëm janë të ndryshme nga ato të mëparshmet. Literatura mbi migracionin në të kaluarën përgjithësisht ishte fokusuar në mënyrat e përshtatjes së emigrantëve në vendin pritës dhe jo në kontaktet me vendin e origjinës (Gordon 1964; Portes & Rumbaut 1996; Alba & Nee 1997). Koncepti i transnacionalizmit e ndryshoi këtë qasje.

2.2.1 Transnacionalizmi si produkt i ndryshimeve strukturore globale

Linda Basch, Nina Glick Schiller, dhe Cristina Blanc-Szanton (1992) argumentojnë se transnacionalizmi është një produkt i ndryshimeve strukturore të sistemit kapitalist në fund të shekullit të njëzetë. Tashmë marrëdhëniet dhe aktivitetet e përditshme të emigrantëve shtrihen nga vendet pritëse drejt vendeve të origjinës. Basch, Glick Schiller dhe Blanc-Szanton (1994, f. 7) përcaktojnë transnacionalizmin si “proces me të cilin transemigrantët, përmes aktiviteteve të tyre të përditshme, ushqejnë marrëdhëniet e shumëllojshme sociale, ekonomike dhe politike që lidhin vendin e tyre të origjinës me vendin pritës, midis të cilave ata shërbejnë si ura lidhëse.”

2.2.2 Transnacionalizmi si produkt i forcave sociale

Portes (2001) beson se transnacionalizmi është produkt i forcave sociale dhe ekonomike që prodhon kapitalizmi bashkëkohor. Në kundërshtim me Basch et al. (1994), Portes (1996) fokusohet kryesisht në aspektin ekonomik të transnacionalizmit, krijimin e sipërmarrjeve transnacionale. Aktivitetet transnacionale të biznesit nxiten nga zgjerimi i vazhdueshëm i ekonomisë kapitaliste, e cila rrit kërkesën për punën e emigrantëve në vendet e zhvilluara. Për shkak të pagës së ulët dhe punës manuale, emigrantët ndërtojnë sipërmarrje ekonomike ndërkufitare në mënyrë që të përmirësojnë mobilitetin e tyre ekonomik. Shfrytëzimi i mundësive është lehtësuar nga përparimi teknologjik. Gjithashtu, Portes (2001) argumenton se armiqësia dhe diskriminimi mund të sjellin krijimin e sipërmarrjeve transnacionale. Kur emigrantët e gjejnë veten në kontekste armiqësorë, duke u përballur me disavantazhet dhe përjashtimin social, ata e gjejnë zgjidhjen duke u angazhuar në aktivitete transnacionale të biznesit për mobilitetin ekonomik.

2.2.3 Çfarë e nxit transnacionalizmin bashkëkohor?

Portes (2001) nënvizon se transnacionalizmi rrallë herë nxitet nga qeveritë e vendeve dërguese. Megjithatë, qeveritë e vendeve dërguese marrin pjesë në këtë proces, kur rëndësia dhe potenciali i sipërmarrjeve transnacionale bëhet evidente. Qeveritë bëjnë ndryshime dramatike në politikat e tyre, si dhënien e shtetësisë së dyfishtë, dhënien e të drejtës së votës dhe ndryshime të tjera të legjislativës. Foner (2005, f. 70) ilustron se si, përveç ndryshimeve ekonomike dhe përparimeve teknologjike, faktorë të tjerë, si praktikat politike dhe kornizat ligjore, çojnë në bashkëpunim ndërkufitar dhe sipërmarrjet transnacionale.

2.2.4 Klasifikimi i transnacionalizmit

Aktivitetet transnacionale varrojnë nga lidhjet individuale në institucionet transnacionale. Smith dhe Guarnizo (1998) e klasifikojnë transnacionalizmin në transnacionalizëm “nga lart” (kapitali global, media dhe institucionet politike) dhe në transnacionalizëm “nga poshtë” (aktivitet lokale). Transnacionalizmi “nga lart” i referohet aktiviteteve transnacionale të kryera nga aktorë të fuqishëm institucional (shtetet dhe korporatat multinacionale), ndërsa transnacionalizmi “nga poshtë” i referohet aktiviteteve bazë të kryera nga emigrantë dhe homologë të tyre në vendet e origjinës.

Itzigsohn, Cabral, Medina, dhe Vazquez (1999) bëjnë dallim midis transnacionalizmit “të ngushtë” (aktivitete të institucionalizuara dhe vazhdueshme) dhe “të gjerë” (lidhjeve të rastit). Transnacionalizmi i “ngushtë” u referohet aktiviteteve transnacionale me një nivel të lartë institucionalizimi, përfshirje të vazhdueshme dhe lëvizje të rregullt. Transnacionalizmi i “gjerë” u referohet aktiviteteve transnacionale me një nivel të ulët institucionalizimi, përfshirje të rastit dhe lëvizje sporadike.

Itzigsohn et al. (1999) i ndajnë praktikatat transnacionale në katër kategori: ekonomike, politike, civile-shoqërore dhe kulturore. Transnacionalizmi ekonomik i referohet përfshirjes së emigrantëve në aktivitetet e biznesit që zhvillohen në vendin pritës dhe në vendin e origjinës. Për ilustrim mund të përdorim si firmat transnacionale, ashtu edhe emigrantët shqiptarë që sjellin çanta me mallra në udhëtimet e rastit në Shqipëri. Ndërkohë, transnacionalizmi politik u referohet anëtarësimit dhe aktivizimit në partitë politike shqiptare apo veprimtaritë elektorale të emigrantëve në Greqi dhe Itali. Kategoria civile-shoqërore u referohet praktikave fetare apo sportive të komunitetit, pra veprimtarive jo politike dhe jo tregtare. Praktikatat kulturore u referohen praktikave simbolike, si formimi i identiteteve, shijeve dhe vlerave.

Studimi im, duke adresuar praktikatat ekonomike transnacionale të emigrantëve shqiptarë, u referohet emigrantëve, të cilët kanë ndërtuar biznese në Itali e Greqi dhe hapin biznese edhe në Shqipëri. Shumica e bizneseve etnike të shqiptarëve janë përqendruar në sektorët e shërbimit, tregtisë dhe ndërtimit. Në sektorin e shërbimeve, llojet më të përhapura të bizneseve etnike janë firmat e transportit dhe dyqanet e pjesëve të këmbimit për makinat. Bizneset tregtarë janë të përqendruara në dyqanet e veshjeve dhe ushqimeve. Gjithashtu, një pjesë e emigrantëve krijojnë firma ndërtimi. Përveç firmave formale transnacionale, në treg janë gjithashtu të pranishme edhe praktikatat informale. Një shembull i tillë janë individët që udhëtojnë shpesh për të furnizuar bizneset e tyre në Shqipëri. Ata marrin mallra nga Italia dhe Greqia dhe i sjellin në Shqipëri informalisht.

Transnacionalizmi është kryesisht një fenomen i lidhur me migracionin. Megjithatë, Portes (2003, f. 875) paraqet një tipologji që dallon midis aktiviteteve të shteteve, institucioneve globale, dhe aktorëve privatë (Tabela 1). Klasifikimi i Portes (2003) tregon se transnacionalizmi u referohet kryesisht aktiviteteve ndërkufitare të individëve.

TABELA 1. AKTIVITETET NDËRKUFITARE TË NDËRMARRA NGA OPERATORË TË NDRYSHËM

Zonat	Politike	Ekonomike	Socio-kulturore
Internacionale	Krijimi i ambasadave dhe organizimi i misioneve diplomatike jashtë vendit nga qeveritë kombëtare	Exportet e një vendi në bujqësi, ferma dhe peshkim	Programet e shkëmbimit të organizuara nga universitetet e një vendi
Multinacionale	Kombet e Bashkuara dhe agjencitë e tjera ndërkombëtare të ngarkuar me monitorimin dhe përmirësimin e kushteve të jetesës globalisht.	Prodhimi dhe aktivitetet e marketingut të korporatave globale, fitimi i të cilave varet nga tregjet kombëtare.	Shkollat dhe misionet e sponsorizuara nga Kisha Katolike dhe fetë e tjera globale në vende të ndryshme.
Transnacionale	a) Shoqatat jo-qeveritare të themeluara për të monitoruar të drejtat e njeriut në nivel global. b) Organizata të shoqërisë civile të themeluara nga emigrantët për të ndihmuar komunitetet në vendet e origjinës	a) Bojkotimi i aktivistëve në vendet e zhvilluara për të detyruar multinacionalet të përmirësojnë kushtet e punës në vendet në zhvillim. b) Sipërmarrjet e themeluara nga emigrantët për eksport/import të mallrave për dhe nga vendet e tyre	a) Organizatat bamirëse që promovojnë mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve në vendet e varfra. b) Konkurse bukuri dhe përzgjedhja e grupeve performuese në komunitetet e emigrantëve për të marrë pjesë në festivalet vjetore në qytetin e lindjes.

Burimi: Portes (2001).

2.3 Teoritë mbi sipërmarrjet transnacionale

Lindja e sipërmarrjeve transnacionale ka nxitur debate teorike midis studiuesve. Megjithë rritjen e vëmendjes ndaj sipërmarrjeve transnacionale, njohuritë mbi to janë ende të kufizuara e të fragmentuara. Studiuesit kanë formuluar përkufizime të ndryshme mbi sipërmarrësit transnacionalë, duke krijuar diversitet në përshkrimin e arsyeve e mënyrave nëpërmjet të cilave individët angazhohen në sipërmarrjet transnacionale.

2.3.1 Përkufizimi i sipërmarrjes transnacionale

Nuk ka ende një përkufizim të përbashkët për sipërmarrjen transnacionale. Nga perspektiva e biznesit, Yeung (2002, f. 37) përkufizon sipërmarrësit transnacional si “*aktorë social të aftë për përballuar rreziqet dhe për të marrë iniciativa strategjike për të krijuar, integruar, dhe mbështetur operacionet e huaja*”. Yeung paraqet tretribute të ndërlidhur, të pranishëm në procesin sipërmarrës: kontrolli mbi burimet, aftësitë në menaxhimin strategjik, aftësitë për të krijuar dhe shfrytëzuar mundësitë. Nga perspektiva sociologjike, sipërmarrësit transnacionalë janë një nëngrup i sipërmarrësve etnikë shpesh të përkufizuar si pronarë biznesesh”, “*të cilët dallohen nga aftësitë për tu vetë identifikuar dhe për tu përshkruar nga të tjerët*” (Waldinger & Aldrich 1990, f. 113). Portes et al. (2002, f. 284) i përcaktojnë sipërmarrësit transnacionalë si “*individë të cilët udhëtojnë jashtë vendit të paktën dy herë në vit për biznes dhe suksesi i të cilëve varet nga kontakti i rregullt me vendet e huaja*.” Ata e shohin frekuencën e udhëtimit jashtë vendit si një tipar përcaktues të sipërmarrjes transnacionale.

Rusinovic (2008) nuk përfshin frekuencën e udhëtimit jashtë vendit dhe as suksesin e biznesit si të varur nga kontaktet transnacionale, por i përkufizon sipërmarrësit transnacional si sipërmarrës të cilët krijojnë aktivitete transnacionale, nëpërmjet kontakteve apo bashkëpunëtorëve të tyre në një vend tjetër, kryesisht në vendin e origjinës.

2.3.2 Llojet e sipërmarrjeve transnacionale

Landolt, Autler, dhe Baires (1999) kanë identifikuar pesë lloje sipërmarrjesh transnacionale: sipërmarrjet qarkulluese, sipërmarrjet kulturore, sipërmarrjet etnike, mikro-sipërmarrjet etnike, dhe sipërmarrjet e zgjerimit transnacional. Sipërmarrjet qarkulluese përfshijnë transferimin e mallrave dhe remitancave midis vendit të origjinës dhe vendit pritës të migrantëve. Sipërmarrjet kulturore përfshijnë ndërmarrjet që prodhojnë dhe shpërndajnë mediat e emigrantëve (gazeta, programe televizive) dhe bizneset që prodhojnë ose shpërndajnë mallra nga vendet e emigrantëve (ushqim dhe pije), duke promovuar identitetin kombëtar të emigrantëve. Sipërmarrjet etnike janë firmat e vogla tregtarë që furnizohen me mallra të importuara nga vendi i origjinës dhe i shërbejnë komunitetit të emigrantëve. Mikro-sipërmarrjet janë firma të themeluara nga emigrantët e kthyer në vendin e tyre dhe që mbështeten në lidhjet transnacionale. Llojet më të zakonshme të mikro-ndërmarrjeve përfshijnë restorante, shitje dhe riparime pjesësh për automjete dhe materiale kancelarie. Emigrantët e kthyer që kanë punuar në restorante në vendet pritëse, shpesh hapin filiale të restoranteve në Shqipëri dhe marrin lëndët e para dhe produktet nga jashtë. Së fundi, sipërmarrjet e zgjerimit transnacional janë kompani që plotësojnë nevojat të veçanta të emigrantëve.

3. Pengesat për transnacionalizmin në Ballkan dhe Shqipëri

Në Ballkan ka një vonesë të rrjeteve dhe sipërmarrjeve transnacionale. Kjo vonesë është për shkak të shumë faktorëve si mosmarrëveshjet e vazhdueshme etnike, fetare, territoriale dhe politike; zhvillimi ekonomik i ngadaltë; kushtet e pafavorshme për biznes; dhe integrimi evropian.

Afërsia gjeografike duhet të kishte prodhuar e nxitur aktivitete ekonomike intensive në Ballkan. Megjithatë, atë që “gjeografia” ka ofruar për njerëzit në rajon, e ka penguar dhe komplikuar “historia” e tyre. Rënia e komunizmit dhe rishfaqja e shteteve të vogla dhe multietnike ndikuan në rigjallërimin dhe acarimin e konflikteve etnike, fetare, kulturore dhe territoriale brenda shteteve, si dhe në marrëdhënie problematike ndërshtetërore në rajon. Gjatë shekullit të kaluar, marrëdhëniet midis vendeve, popullsisë, shteteve dhe madje edhe njerëzve, në rajon kanë qenë të mbizotëruara nga aktivitete joekonomike. Rrjedhimisht, Ballkani nuk është zhvilluar si një rajon-kantier, me tregti, investime të huaja dhe integrim ekonomik, por kryesisht si një rajon me konflikte dhe tensione të vazhdueshme.

Vonesa e rrjeteve transnacionale ekonomike në rajon është e lidhur edhe me faktin se vendet e Ballkanit nuk kanë qenë në gjendje për të prodhuar flukse emigruese dhe imigruese nga dhe drejt njeri-tjetrit. Tradicionalisht ata kanë qenë kryesisht vende dërguese emigrantësh dhe kanë dështuar në akomodimin e imigrantëve si vende pritëse për shkak të ekonomive të tyre të dobëta. Prodhimi i flukseve migratore nga vendet e Ballkanit drejt këtyre vendeve është pothuajse jo-ekzistent për shkak të ngjashmërive që ata kanë në zhvillimin ekonomik, sistemin e mirëqenies dhe rritjen ekonomike në këto vende Ballkanike. Në përgjithësi, modernizimi ekonomik në Ballkan ka mbetur prapa atij të Europës Perëndimore dhe madje edhe pjesës tjetër të Evropës Lindore, ku lulëzojnë ekonomi të përparuara. Si rezultat, emigrantët ballkanas kanë tendencë të migrojnë jashtë gadishullit, drejt vendeve perëndimore.

Përveç kësaj, vendet e Ballkanit nuk kanë krijuar ende kushtet për një mjedis të mirë biznesi. Të bësh biznes në këto vende është shpesh e vështirë për shkak të paqëndrueshmërisë politike dhe sociale, ligjeve jo inkurajues, burokracisë, korrupsionit, infrastrukturës së varfër, mungesës së incentivave financiare dhe ndryshimeve të vazhdueshme në kuadrin ligjor. Të gjithë këta faktorë i bëjnë vendet e Ballkanit partnerë biznesi jo të besueshëm.

Mungesa e bashkëpunimit ekonomik rajonal i atribuohet edhe procesit të integritimit evropian. Avancimi i rajonit drejt Bashkimit Evropian po ndikon lidhjet ndërkombëtare në rajon. Shtetet në Ballkan promovojnë lidhjet transnacionale ekonomike me BE-në, duke neglizhuar ose dështuar të shfrytëzojnë bashkëpunimin rajonal. Prandaj vendet e Ballkanit kanë të prioritarizuar lidhjet ekonomike me vendet e BE.

4. Përkufizime dhe pyetjet kërkimore

Fokusi kryesor i këtij studimi është sipërmarrja transnacionale e emigrantëve dhe emigrantëve të kthyer. Sipërmarrësit transnacionalë mund të jenë emigrantë ose emigrantë të kthyer. Sipërmarrësit transnacionalë emigrantë janë shtetas shqiptarë që kanë punuar në Itali/Greqi për një periudhë më të gjatë se 12 muaj të njëpasnjëshëm, kanë themeluar një biznes jashtë vendit, suksesi i të cilit varet nga marrëdhëniet dhe praktikat pak a shumë të rregullta me Shqipërinë. Sipërmarrësit transnacionalë emigrantë të kthyer janë shtetas shqiptarë, të cilët kanë punuar dhe/ose studiuar/jetuar në Itali/Greqi për një periudhë më të gjatë se 12 muaj të njëpasnjëshëm dhe pastaj janë kthyer dhe kanë themeluar një biznes në Shqipëri ose zgjeruar një biznes që kanë filluar jashtë vendit, suksesi i sipërmarrjes së të cilëve varet nga marrëdhëniet dhe praktikat ndërkufitare pak a shumë të rregullta. Frekuenca e marrëdhënieve ndërkufitare varet nga veprimtaria e sipërmarrjeve.

Ka disa lloje ndërmarrjesh shqiptare transnacionale, midis të cilave mund të përmendim: i) sipërmarrje që prodhojnë në Shqipëri për shkak të kostos më të ulët të punës dhe shesin produktet e tyre në Itali apo Greqi, si për shembull, prodhimi i veshjeve dhe këpucëve për eksport; ii) biznese të shitjes së veshjeve dhe produkteve ushqimore, të krijuara nga emigrantët që punojnë në bizneset e shitjes me pakicë në vendet pritëse dhe krijojnë gjithashtu degë në Shqipëri; iii) kompani import-eksporti ose sipërmarrësit që zhvillojnë tregti transnacionale; shërbime ushqimore ose restorante të emigrantëve të kthyer në Shqipëri në pronësi individuale dhe familjare. Pyetjet kërkimore fokusohen në analizën e trendit, karakteristikave, faktorëve dhe nevojave për mbështetje të përfshirjes së emigrantëve shqiptarë në sipërmarrjet transnacionale që burojnë nga migracioni.

5. Metodologjia e kërkimit

Për kryerjen e këtij studimi po përdor metoda kërkimi të përziera. Të dhënat po i grumbulloj nëpërmjet metodave të ndryshme dhe nga disa burime, duke përfshirë: intervistat, analizën e përmbajtjes së kuadrit ligjor, dokumenteve dhe literaturës, dhe sondazhet online. Kërkimin e kam organizuar në dy faza. Në fazën e parë (kualitative), do të kryej intervista të gjysmë-strukturuara ballë-për-ballë me sipërmarrësit transnacional. Në fazën e dytë (kuantitative) do të zhvilloj sondazhe online me sipërmarrës shqiptarë, të punësuar në sipërmarrjet e tyre, dhe individë të tjerë të përfshirë në biznese transnacionale. Puna në fushë do të zhvillohet në Shqipëri, Itali dhe Greqi. Gjithashtu, para se të shkoj në terren, do të reflektoj mbi pozicionalitetin tim, duke konsideruar ngjashmëritë dhe dallimet midis meje dhe pjesëmarrësve të kërkimit.

5.1 Teknikat e kërkimit

5.1.1 Metodatat kërkimore kualitative

Për të grumbulluar informacion të detajuar mbi sipërmarrësit transnacional shqiptarë dhe aktivitetet e tyre sipërmarrëse zgjedha intervistat gjysmë të strukturuara, ballë-për-ballë. Kjo zgjedhje nisët nga konsiderata se sipërmarrja etnike është një fenomen në rritje në Shqipëri dhe intervistat mund të më japin një kuptim më të gjerë e të thellë të kontekstit dhe mund të më ndihmojnë për të zhvilluar një pyetësor të përshtatshëm për fazën e dytë të kërkimit.

Pyetjet e intervistës shqyrtojnë karakteristikat, qëndrimet, dhe aspiratat e të anketuarve; përvojat e të jetuarit dhe punuarit e emigrantëve në Shqipëri; përshtatjen e emigrantëve të jetës në Itali dhe Greqi; kushtet e biznesit në Shqipëri; burimet e përdorura për zhvillimin e biznesit transnacional; dhe procesin e përgjithshëm në detaje.

Pjesëmarrësit e kërkimit shkencor do të përzgjidhen në disa mënyra, ndër më të rëndësishmet prej të cilave është është *snowballing*: përdorimi i të intervistuarve për të sugjeruar të intervistuar të tjerë. Për të rritur larminë e të intervistuarve dhe të anketuarve, do të përdor edhe teknika të tjera. Pjesëmarrësit e kërkimit do të kontaktohen nëpërmjet rrjeteve profesionale dhe private, kontakteve me organizata të biznesit, agjenci qeveritare dhe joqeveritare, organizata formale dhe shoqata të tjera të emigrantëve. Gjithashtu pjesëmarrësit do të identifikohen përmes Programit Brain Gain, një iniciativë qeveritare për të tërhequr emigrantët e kualifikuar shqiptarë për të mbështetur zhvillimin e vendit.

5.1.2 Metodatat kërkimore kuantitative

Në bazë të përgjigjeve që nga intervistat, kam hartuar një pyetësor për një kërkim web-based/online. Pyetësori është kryesisht i mbyllur. Një kombinim i mesazheve të personalizuar, kujtesat nëpërmjet e-mail, dhe konfirmimi i konfidencialitetit po përdoret për të përmirësuar numrin e përgjigjeve. Gjithashtu, në mënyrë që të mos kufizoj kampionin vetëm me individë që kanë akses në e-mail, do të përdor anketimin nëpërmjet postës me punonjës dhe persona të përfshirë në biznese transnacionale.

Pyetësori do të mbledhë të dhëna rreth karakteristikave demografike; motiveve, burimeve, kapitalit social, rrjeteve profesionale dhe private të ndërmarrjeve transnacionale; karakteristikave të ndërmarrjeve transnacionale (sektorët, shërbimet/ produktet, struktura e ndërmarrjes, madhësia, numri i punonjësve, qarkullimi vjetor, marrëdhëniet ndërkufitare); roli i qeverisë shqiptare dhe organizatave të tjera në mbështetjen apo pengimin e sipërmarrjes transnacionale.

5.2 Territori i kërkimit

Kam zgjedhur Italinë dhe Greqinë si dy vendet pritëse më popullore të emigrantëve shqiptarë. Në Greqi, shqiptarët janë grupi më i madh emigrant (Gogonas 2010). Ndërsa në Itali, shqiptarët janë grupi i dytë më i madh emigrant (Dossier Statistikor

mbi Imigracionin 2014). Në Itali, intervistat me sipërmarrësit transnacionalë do të kryhen në rajonet e Lombardi dhe Emilia-Romagna, ku zhvillojnë aktivitetet një numër i madh ndërmarrjesh të emigrantëve, kryesisht biznese të vogla dhe të mesme. Në Greqi, do të intervistoj sipërmarrës transnacional shqiptarë në Athinë dhe Selanik. Ndërsa në Shqipëri, ku shumica e sipërmarrësve transnacionalë janë vendosur në Tiranë, Durrës, Shkodër, Gjirokastrë, dhe Korçë, intervistat do të zhvillohen në Tiranë dhe Durrës. Do të intervistoj gjithashtu sipërmarrës që kanë marrëdhënie ndërkufitare dhe praktika me vende të tjera si Mbretëria e Bashkuar.

5.3 Pozicionaliteti i kërkuesit

Duke ndarë një trashëgimi të ngjashme kulturore, kombëtare, gjuhësore dhe fetare, kam shumë përparësi gjatë zbatimit të studimit kërkimor. Të gjithë këta faktorë po më lehtësojnë krijimin e një raporti të mirë dhe një bisede të bazuar në ndjeshmëri dhe respekt. Atributet dhe përvojat e përbashkëta po më ndihmojnë për të ndërtuar lidhje funksionale me pjesëmarrësit e studimit, e cila i bën ata ta kenë më të lehtë për t'iu përgjigjur pyetjeve të mia lirisht. Gjithashtu, raportet e afërta me të intervistuarit po më ndihmojnë për të pasur informacion të dorës së parë, të kuptoj “gjuhën” e folur dhe të pashprehur të intervistës, përmes përvojave të ngjashme të migracionit, gjuhës dhe kulturës. Pra, këto pikat e lidhjes me të intervistuarit po më heqin disa pengesa që kanë të bëjnë me qasjen time në jetën e tyre.

Megjithatë, faktorë të tjerë si historia personale, faza e ciklit të jetës, arsye e migrimit, moshja, gjinia, dhe klasa shoqërore dhe ekonomike mund të marrin një kuptimin më mbizotërues se atributet e përbashkëta. Për këto arsye, gjatë procesit të intervistave, ndodhem sa brenda, aq edhe jashtë komunitetit të emigrantëve.

Bibliografia

- Alba, R. D. & Nee, V. (1997). Rethinking assimilation theory for a new era of immigration. *International Migration Review*, vol. 31, (Winter), pp. 826–74.
- Basch, L., Glick Schiller, N. & Blanc Szanton, C. (1992). *Towards a transnational perspective on migration: race, class, ethnicity and nationalism reconsidered*. New York: New York Academy of Sciences.
- Basch, L., Glick Schiller, N. & Blanc Szanton, C. (1994). *Nations unbound: transnational projects, post-colonial predicaments, and deterritorialized nation-states*. Langhorne, PA: Gordon and Breach.
- Bonacich, E. (1973). A Theory of Middleman Minorities. *American Sociological Review*, 38:583-594.
- Foner, N. (2005). *Transnationalism old and new. In a new land: A comparative view of immigration*. New York University Press.
- Fukuyama F. (1995). *Trust: The social virtues and the creation of prosperity*. New York: Free Press.
- Gogonas, N. (2010). *Bilingualism and Multiculturalism in Greek Education: Investigating Ethnic Language Maintenance among Pupils of Albanian and Egyptian Origin in Athens*. Newcastle upon Tyne, UK: Cambridge Scholar Publishing.
- Gordon, M. M. (1964). *Assimilation in American life: The role of race, religion, and national origins*. New York: Oxford University Press.
- Itzigsohn, J., Cabral, C. D., Medina, E. H. & Vazquez, O. (1999). Mapping Dominican transnationalism: narrow and broad transnational practices. *Ethnic and Racial Studies*. pp. 316–39.
- Kloosterman, R., van der Leum, J. & Rath, J. (1999). Mixed embeddedness: (in)formal economic activities and immigrant businesses in the Netherlands. *International Journal of Urban and Regional Research* 23 (2): 253-267.
- Kloosterman, R. & Rath, J. (2003). Introduction. In *Immigrant entrepreneurs: Venturing abroad in the age of globalisation*, eds. Robert Kloosterman and Jan Rath. New York: Berg.
- Kyle, D. (1999). The Otavalo trade diaspora: Social capital and transnational entrepreneurship. *Ethnic and Racial Studies* 22:422-46.
- Landolt, P., Autler, L. & Baires, S. (1999). “From ‘Hermano Lejano’ to ‘Hermano Mayor’”: The dialectics of Salvadoran transnationalism.” *Ethnic and Racial Studies* 2: 290-315.
- Light, I. H. & Bonachich, E. (1988). *Immigrant entrepreneurs: Koreans in Los Angeles*. Berkeley: University of California Press.
- Pavlov et al. (2014). *Transnational networks, transnational entrepreneurship and the role of the state: The Cases of Serbia and Albania*.
- Poros, M. V. (2001). The role of migrant networks in linking local labour markets: The case of asian indian migration to New York and London. *Global Networks*, 1, pp. 243-60.
- Portes, A. (1981). Modes of incorporation and theories of labour immigration. In *Global trends in migration. Theory and research on international population movements*. eds. Mary M. Kritz, Charles B. Keeley and Silvano M. Tomasi. New York: Centre for Migration Studies.
- Portes, A. (1995). Economic sociology and the sociology of immigration: a conceptual overview. In: Portes A (ed.) *The Economic Sociology of Immigration: Essays on Networks, Ethnicity, and Entrepreneurship*. (pp. 1-41). New York: Russell Sage Foundation.
- Portes, A. (1996). Transnational communities: Their emergence and significance in the contemporary world-system, in R. P. Korzeniewicz & W. C. Smith (eds.), *Latin America in the world economy*. Westport, Conn.: Greenwood.
- Portes, A. (2001). *Legacies: The story of the immigrant second generation*, University of California Press.
- Portes, A. (2003). Theoretical convergencies and empirical evidence in the study of immigrant transnationalism. *International Migration Review*, No. 37: 874-892.
- Portes, A., Guarnizo, L. E., & Haller, W. J. (2002). Transnational entrepreneurs: An alternative form of immigrant economic adaptation. *American Sociological Review*, 67(2), 278-298.
- Portes, A. & R. Rumbaut. (1996). *Immigrant America: A portrait* (second edition). Berkeley, CA: University of California Press.
- Rusinovic, K. (2008). Transnational embeddedness: Transnational activities and networks among first- and second-generation immigrant entrepreneurs in the Netherlands. *Journal of Ethnic and Migration Studies*, 34(3), 431-451.

- Smith, M. P., & Guarnizo, L. E. (1998). *Transnationalism from below*. New Brunswick, N.J.: Transaction Publishers.
- Statistical Dossier on Immigration. (April 10, 2015). Retrived from http://www.dossierimmigrazione.it/index_en.php
- Waldinger, R., Aldrich, H., & Ward, R. (1990). Opportunities, group characteristics, and strategies. In *Ethnic entrepreneurs. Immigrant business in industrial societies*. Roger Waldinger, Howard Aldrich, Robin Ward and associates. Newbury Park, CA: Sage.
- Wilson, K. & Portes, A. (1980). "Immigrant enclaves: An analysis of the labor market experiences of Cubans in Miami." *American Journal of Sociology* 86 (September): 295-319.
- Yeung, H. W. (2002). Entrepreneurship in international business: An institutional perspective. *Asia Pacific Journal of Management*, 19, 29–61.
- Zhou, M. (2004). Revisiting ethnic entrepreneurship: convergencies, controversies, and conceptual advancements. *International Migration Review*, Vol. 38, No. 3, pp.1040–1074

QËNDRUESHMËRIA E LËVIZJES VETËVENDOSJE NË SFERËN POLITIKE

ORGES ZANI

Universiteti Evropian i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Profili: Teori Politike

ABSTRAKT

Ky punim synon të shqyrtojë ruajtjen e legjitimitetit të Lëvizjes Vetëvendosje që ka koha e krijimit dhe veprimet të saj si një lëvizje e deri më tani që funksionon si një përfaqësuese politike brenda sistemit politik. Duke u mbështetur, kah njëra anë, në modelin analitik të Teorisë Konstruktiviste (Social Movement Framing Theory) dhe, kah ana tjetër, në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave që do të përftohen nëpërmjet intervistave që i janë bërë ish-Liderit të Lëvizjes Vetëvendosja, Albin Kurtit, nëpërmjet Pakos Ahtisaar-i, nëpërmjet programit politik dhe ligjërimeve të ndryshme publike, ky punim do të ndërtojë një tablo më të qartë dhe më të kuptueshme të punës së tij kërkimore. Krijimi i kësaj lëvizjeje, e cila lindi në saj të kundërshtimit kategorik dhe sistematik që iu bë pakos Ahtisari, në të cilën theksohej ushtrimi i sovranitetit juridik, ushtarak dhe politik i Kosovës nën protektoratin ndërkombëtar, u zgjerua gjithnjë e më tepër edhe me tezën e bashkimit kombëtar, deri aty sa të shkohej në zhvillime protestash që çuan në vrasjen e disa mbështetësve dhe burgosjen e Liderit të lëvizjes kah forcat ndërkombëtare. Marrja parasysh e krijimit të këtyre kushteve të reja, sollën krijimin dhe vënien në përdorim të strategjive dhe taktikave të reja, por jo shmangien kah qëllimet e vetë lëvizjes, duke përqasur institucionalizimin e lëvizjes brenda sistemit politik si një përfaqësuese politike dhe parlamentare. Rrjedhimisht, ndryshe kah shumica e lëvizjeve që i kanë shuar qëllimet dhe e kanë humbur legjitimitetin e tyre fill pasi janë përfshirë brenda sistemit politik, ky punim, nëpërmjet rastit të Lëvizjes Vetëvendosja, do të parashtrojë dhe vërtetojë ruajtjen e qëllimeve mbi të cilat u krijua kjo lëvizje dhe mbajtjen gjallë të legjitimitet të kauzës së saj.

Fjalë kyç: *Kundërshtimi (i pakos Ahtisari), Bashkimi Kombëtar, Institucionalizimi (politiko-parlamentar), Legjitimimi*

Hyrje

Shumë shkolla të mendimit socio-politik që janë marrë me shqyrtimin e kauzave dhe organizmit të lëvizjeve shoqërore, i mëshojnë idesë se veprimtaritë e vetë lëvizjeve shoqërore karakterizohen kah katër faza të ecurive-, të cilat ndodhin nëpërmjet shfaqjes së paparashikuar, aderimit apo bashkimit të disa grupeve midis tyre, burokratizimit ose formalizimit (në kuptimin organizativ brenda lëvizjes) dhe shuarjes së lëvizjes, dhe se përmbushjet ose jo të qëllimeve të tyre, në fazën e katërt, arrihen kur ajo funksionon vetëm si lëvizje (Christiansen,2011), duke anashkaluar faktin se një lëvizje shoqërore mund t'i arrijë qëllimet e saj edhe duke funksionuar si një parti politike. Ndërkohë, për aq sa janë të vërteta të tilla studime që bazohen dhe analizojnë të dhëna të mirëfillta empirike, po për aq ky punim mëton të pohojë,duke u mbështetur në Teorinë Konstruktivistike të veprimit kah brenda dhe jashtë institucioneve dhe në rastin e Lëvizjes Vetëvendosja, se ekziston një raport legjitim brenda kësaj Lëvizjeje, si në kohën kur funksiononte si lëvizje, po ashtu edhe tani që vepron si parti politike. Duke qenë se çdo lëvizje shoqërore krijohet dhe e zhvillon veprimtarinë e saj mbi bazën kundërshtimit të presionit që mund të ushtrojnë institucionet shtetërore apo jo shtetërore në lidhje me mosnjohjen apo mos pranimin e tipareve dhe sjelljeve të ndryshme socio-kulturore, fiziologjike, gjinore, racore dhe politike të këtyre grupimeve, kjo bëri që edhe Lëvizja Vetëvendosja, fill pak vite pas mbarimit të luftës në Kosovë dhe pas mosnjohjes së Republikës së Kosovës kah Rusia nëpërmjet vendosjes së vetos së saj në OKB, të lindte si rezultat i kundërshtimit që iu bë Pakos Ndërkombëtare të ofruar kah përfaqësuesi Ahtisari për Kosovën, e cila vështrohej dhe konsiderohej kah disa grupime njerëzish si një Protektorat Ndërkombëtar që cenonte thelbësisht sovranitetin politik, juridik dhe ushtarak të vetë Republikës së Kosovës. Me krijimin e saj qenë vitin 2004-ër, kjo lëvizje u karakterizua nga ecuri protestash të herëpashershme që theksonin kundërshtinë e tyre jo vetëm ndaj ushtrimit të pushtetit të ndërkombëtarëve nëpërmjet pakos Ahtisari, por akuzonin njëkohësisht dhe aktorët e brendshëm politikë të Kosovës që mbështesnin këtë marrëveshje, çka i bëri udhë artikullimit dhe mëshimit të tempit të lëvizjes edhe në kauzën e Bashkimit Kombëtar, si një taktikë mbase për të angazhuar sa më shumë veprimtarë në këtë lëvizje. Vijueshmëria për disa vite rresht e zhvillimit të protestave edhe të dhunshme, kulmoi me vrasjen e dy veprimtarëve të saj më 10 shkurt të 2007-ës dhe me burgosjen e ish-Liderit të Lëvizjes Vetëvendosja, Albin Kurti. Marrja parasysh e krijimit të këtyre kushteve të reja, sollën krijimin dhe vënien në përdorim të strategjive dhe taktikave të reja, por jo shmangien kah qëllimet e vetë lëvizjes, duke përqsuar institucionalizimin e lëvizjes si Parti politike dhe si përfaqësuese legjislative e mbështetësve të saj, fill me zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2010. Rrjedhimisht, ndryshe kah shumica e lëvizjeve që i kanë shuar qëllimet dhe e kanë humbur legjitimitetin e tyre fill pasi janë kthyer në parti politike, ky punim, nëpërmjet rastit të Lëvizjes Vetëvendosja, që tashmë është një Parti, do të parashtrijë dhe vërtetojë ruajtjen e qëllimeve mbi të cilat u krijua kjo lëvizje dhe mbajtjen gjallë të legjitimitet të kauzës së saj.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Zhvillimi i ndodhi bërjeve politike të pasluftës në Kosovë, të shoqëruara dhe me një paketë protektorati ndërkombëtar, ofroi mundësinë për të ndërmarrë një lëvizje të gjerë shoqërore. Kundërshtimi i paketës së Ahtisarit, e cila, në thelb, sipas Lëvizjes Vetëvendosja, cenonte ushtrimin e sovranitetit politik dhe juridik të vetë shtetit të Kosovës, u bë arsyeja e krijimit të vetë Lëvizjes rrugëtimi i së cilës, për një kohë të konsiderueshme, u drejtua nga ndërmarrja e politikave kundërshtuese edhe me protesta të dhunshme. Presioni i herëpashershëm i ushtuar nga Lëvizja Vetëvendosja karshi ndërkombëtarëve dhe aktorëve shtetërorë politikë, kulmoi më 10 shkurt të vitit 2007-të, ku dy veprimtarë të saj gjetën vdekjen si rezultat i përdorimit të armëve nga ndërkombëtarët. Rrjedhimisht, kjo do të thotë se nëse udhëheqësi dhe anëtarët e lëvizjes e kanë konsideruar kundërpërgjigjen e ashpër të ndërkombëtarëve si një ngushtim hapësirash për ecurinë e mëtejshme të lëvizjes, atëherë zhvendosja dhe shndërrimi i saj në një parti politike mund të konsiderohet si një taktikë që shkon për kah përshtatja me kontekstin në të cilin duhet të gjallojë edhe vetë lëvizja si e tillë. Pak a shumë, kërkimi i hapësirave për gjetjen dhe përdorimin e mjeteve të reja (siç ishte krijimi i partisë dhe fitimi, fillimisht, i dymbëdhjetë vendeve në parlament) mund të shihet si mekanizmi i mundshëm për t'u vënë krahas aktorëve të tjerë politikë me të njëjtat linja të operimit institucional. Rritja e bashkëpunimit me aktorët e tjerë opozitarë dhe bashkërendimi i politikave jo vetëm me anëtarët e vetë lëvizjes, por edhe me ata njerëz që ishin dhe janë të zhgënjyer nga partitë në pushtet, për shkak të mos realizimit dhe konkretizimit të nismave të tyre politike për kah nevojat dhe kërkesat e zgjedhësve të tyre, mund të nxisin forcimin e pozitave institucionale dhe rritjen e mundësisë për të ardhur në pushtet, çka ofron, më pas, hapësira të mëtejshme jo vetëm në realizimin e qëllimeve themelore mbi të cilat u konfigurua vetë lëvizja, por edhe në rritjen e mundësive për qytetarët për t'u drejtuar kah përmbushja e pritshmërive të parealizuara, që më parë, nga partitë në pushtet.

Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Ndërkohë që Lëvizja Vetëvendosja u krijua si lëvizje në kushte dhe rrethana të cilat sinjifikonin kryesisht mosnjohjen e Pakos Ahtisari dhe thirrjen për Bashkim Kombëtar, tashmë kemi të bëjmë jo vetëm me konfigurimin e statusit politik të saj si një përfaqësuese parlamentare, por edhe dhe me ndryshime të kushteve dhe rrethanave të brendshme dhe të jashtme politike. Kështu, duke qenë se, nga njëra anë, partitë në pushtet qeverisës vijojnë përgjithësisht ndjekjen e udhës politike të paketës

Ahtisari, ndërsa ndërkombëtarët i mëshojnë kryesisht integritet të Republikës së Kosovës në BE dhe jo thirrjeve për Bashkim Kombëtar, pyetja që lind vetvetiu është kjo:

A mund të ekzistojnë më lidhjet e drejtpërdrejta midis përmbajtjes dhe objektivave që shpaloste lëvizja që më parë, me përmbajtjen dhe qëllimet politike që e karakterizojnë tanimë atë si një lëvizje brenda sistemit politik?

Formulimi dhe marrja në shqyrtim studimor e kësaj pyetjeje të domosdoshme kërkimore, do t'i bëjnë udhë punimit jo vetëm për dhënien thjesht të një përgjigjeje ndaj saj, por edhe për vërtetimin me sa më shumë objektivitet të kësaj pyetjeje duke theksuar, se Lëvizja Vetëvendosja ka arritur të ruajë legjitimitetin e kauzës së saj, që kah koha e krijimit dhe veprimit të saj si një lëvizje e deri më tani që funksionon dhe vepron si një Parti politike. Për t'i bërë sa më objektive dhe sa më të qëndrueshëm argumentimet dhe analizat e këtij kërkimi shkencor, ndërtimi i modelit të analizës së këtij punimi do të mbështetet jo vetëm në Teorinë konstruktiviste të lëvizjeve shoqërore (Social Movement Framing Theory), ku theksohet roli dhe funksioni ndërveprues midis agentit dhe strukturës apo midis agjencisë dhe strukturës, por edhe në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave empirike që do të përftoheshin nëpërmjet intervistave që i janë bërë ish-Drejtesit të Lëvizjes Vetëvendosja, në programin politik të lëvizjes dhe në ligjërimet verbale apo të shkruara të drejtuesve të lëvizjes.

Krijimi dhe zhvillimi i lëvizjes në sajë të kundërshtimit të Pakos së Ahtisarit dhe mbështetjes në Bashkimin Kombëtar

Ndryshe nga ravijëzimi ideologjik dhe racional i partive politike, lipset të thuhet se sendërtimi i lëvizjeve shoqërore karakterizohet nga “përpjekje të ndërmarra kah një numri madh njerëzish për të zgjidhur problemet të cilat ata i ndiejnë se i kanë të përbashkëta mes tyre” (Toch, 1965, fq. 5). Përcaktimi i një formulimi të tillë nënkupton jo vetëm ruajtjen dhe përmirësimin e marrëdhënieve vepruese që bazohen në tipare të ndryshme sociologjike, fiziologjike (raca, ngjyra e lëkurës, seksi) dhe estetike (gjuha e përbashkët, besim fetar, ndërgjegje kombëtare, etj.), por edhe kundërshtimin e atyre politikave qeverisëse që diskriminojnë ose anashkalojnë respektimin e këtyre tipareve. Duke u bazuar mbi këto premisa, të cilat arrijnë të shfaqin kuptueshmërinë dhe shpjegimin e natyrës së brendshme të lëvizjeve shoqërore, kjo do të thotë se, nga njëra anë, kemi të bëjmë me lëvizje shoqërore që sendërtohen kah “politika kundërshtuese të mbështetura në rrjete shoqërore që theksojnë ushtrimin e veprimit kolektiv dhe aftësia e të cilave përmirëson ecurinë e sfidave kundërshtuese ndaj kundërshtarëve të pushtetshëm” (Tarroë, 1998, fq. 2). Ndërkohë, nga ana tjetër, përfaqësja e lëvizjeve shoqërore shpalos “sfida kolektive të bazuara mbi qëllime të përbashkëta dhe solidaritete shoqërore të cilat mbështesin ndërveprimin me elitat, kundërshtarët dhe autoritetet” (Tarroë, 1998 a, fq. 4).

Përshkrimi i bërë më sipër na jep mundësinë që në këtë çështje të parë të merremi me shqyrtimin e krijimit dhe zhvillimit të lëvizjes shoqërore nëpërmjet ecurisë kundërshtuese të saj. Megjithatë, për t'i bërë sa më të shqeshme domethëniet kundërshtuese të lëvizjes shoqërore, punimi do të përqipet të paraqesë shembullarizimin e rastit të Lëvizjes Vetëvendosje, si një lëvizje e ndodhur në Kosovë. E gjendur në një situatë jo shumë të favorshme në lidhje me rregullimin e ecurive të marrëdhënieve politike, ekonomike, kulturore dhe shoqërore, për shkak të luftës së zhvilluar me Serbinë dhe pasojave që sollin kjo luftë, Kosovës iu desh që, nën drejtimin e Kombeve të Bashkuara, t'i nënshtrohej protektoratit të shteteve ndërkombëtare, ku në nenin dy fraksion një të aneksit nëntë të Pakos Ahtisaari (Përfaqësuesi i OKB-së, i ngarkuar me punë në Kosovë për hartuar një paketë masash ligjore mbi atë se si duhej të funksiononte shteti i Kosovës, dhe që do të shërbente më pas për krijimin e kushtetutës së Kosovës), që ka të bëjë me ushtrimin e mandatit dhe pushtetit të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, thuhet: “Sa i përket mbikëqyrjes së përgjithshme të zbatimit të kësaj zgjidhjeje, PCN-ja do të ketë pushtetin suprem në Kosovë sa i përket interpretimit të aspekteve civile të kësaj zgjidhjeje” (Pakoja e Ahtisaari-i, 2007, Aneksi IX, fq. 58). Pamundësia dhe mbase paaftësia e klasës politike kosovare për të krijuar një shtet të mëvetshëm dhe të pavarur në Kosovë- kjo për shkak edhe të konjunkturave të ndryshme, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij- bënë që më “12 Qershor të vitit 2005” (Historiku i ‘Lëvizjes Vetëvendosje!') të krijohej një lëvizje e cila, në themel të saj, mbronte jo vetëm çështjen e krijimit të pavarësisë dhe sovranitetit të pa cunguar të Kosovës, por edhe bashkimin e Shqipërisë me Kosovën, pavarësisht se Dispozitat e përgjithshme të Pakos Ahtisaari, e cila u shndërrua dhe në një Kushtetutë për Kosovën, në nenin një fraksion shtatë dhe tetë pohojnë: “Kosova do të ketë simbolet e veta të veçanta nacionale, duke përfshirë flamurin, stemën dhe himnin, të cilët pasqyrojnë karakterin e saj shumetnik. Kosova nuk do të kërkojë bashkim me asnjë shtet apo pjesë të ndonjë shteti” (Pakoja e Ahtisaari-t, 2007 a, Dispozitat e Përgjithshme, fq. 3).

Shpalosja e një teze të tillë nga Lëvizja Vetëvendosje, në plan të parë, përbente një problem madhor jo vetëm për ndërkombëtarët, por edhe për aktorët politikë kosovarë “të cilët në takimet që kanë patur me Kryeministrin Berisha në vitet 1991-92-93, i kanë mëshuar më tepër idesë së krijimit të shtetit të Kosovës sesa bashkimin kombëtar” (Kurti, 2 Dhjetor 2010). Parë në këtë këndvështrim, mund të thuhet se Lëvizja Vetëvendosje e ka nisur veprimtarinë e saj përmes një politike të mirëfilltë kundërshtuese, e artikuluar si një kundërveprim karshi politikave të tilla ndërkombëtare dhe mbështetësve të brendshëm të këtyre politikave, pasi për Lëvizjen Vetëvendosje, “identiteti kosovar është një identitet gjeografik, i cili është shumë larg prej të qenit identitet kombëtar, sepse nuk ekziston kombi kosovar, madje më i fuqishëm është identiteti drenicak sesa ai kosovar, dhe mbi të gjitha këto, qëndron identiteti kombëtar” (Kurti, 2 Dhjetor 2010 a). Ndërmarrja e një nisme të tillë nga Lëvizja Vetëvendosja, ku përcaktohet mbrojtja dhe fuqizimi i një ndërgjegjeje dhe kujtese mbarëkombëtare, kërkon

domosdoshmërinë e formatimit të shënjesve të tillë simbolikë nga njëra anë, për të theksuar se “ravijëzimet e veprimeve kolektive mohojnë pandryshueshmërinë e një situate të padëshirueshme dhe mundësojnë ndryshimin e saj nëpërmjet një forme të veprimit kolektiv” (Gamson & Meyer, 1996, fq. 285). Nga ana tjetër, lipset gjetja dhe përdorimi i mjeteve që do të bëjnë të mundur mbarëvajtjen e mëtejshme të një çështjeje të tillë, sepse megjithëse ekziston një kodik i tillë ligjërues i tipit përgjithësues, sipas Meyer dhe Rochon (1997), lëvizjet shoqërore përbëhen nga koalicionet e aktorëve të cilët veprojnë sipas përmes elementëve të krijuar mbi qëllime të përbashkëta, po aq edhe mbi ndeshjen e shfaqjeve të pretendimeve dhe taktikave të përcaktuara, duke bërë që pavarësia dhe sovraniteti i Kosovës të nënkuptojnë katër elementë, sipas Lëvizjes Vetëvendosje: “njohja nga Kombet e Bashkuara, krijimi i një ushtrie të mirëfilltë të drejtuar nga institucioni i Ministrisë së Mbrojtjes (të drejtuar vetëm nga shqiptarët e Kosovës), integriteti territorial dhe krijimi i Ministrisë së Jashtme me të drejta vendimmarrëse” (Kurti, 3 Janar 2008).

Mirëpo, sipas Vetëvendosjes, pavarësisht pretendimeve të ngritura nga vetë lëvizja, faktorët ndërkombëtarë nëpërmjet një pakete të hartuar nga Ahtisaari, vendosën që të krijonin një shtet të Kosovës të drejtuar dhe të vëzhguar nga faktorët ndërkombëtarë, duke anashkaluar plotësisht realizimin e katër pikave të mësipërme, pasi në nenin një fraksion tre dhe katër të aneksit njëmbëdhjetë, që përcakton kompetencat e pranisë ushtarake ndërkombëtare, dhe në nenin trembëdhjetë fraksion një dhe dy të aneksit tre mbi decentralizimin thuhet:

PUN-ja (përfaqësuesi ushtarak ndërkombëtar) do të mbikëqyrë dhe monitorojë FSK-në (forcat e sigurisë së Kosovës) dhe do të ketë autoritet ekzekutiv mbi të, derisa PUN-ja, në bashkërendim me PCN-në (përfaqësuesi civil ndërkombëtar), të konstatojë se kjo forcë është e vetëqëndrueshme dhe e aftë t'i kryejë detyrat që i janë caktuar në përputhje me standardet ndërkombëtare. PUN-ja, në konsultim me PCN-në dhe Kosovën, do të ketë pushtetin ekzekutiv mbi TMK-në (trupi i mbrojtjes së Kosovës), dhe do të vendosë për kohën e shpërbërjes së TMK-së, ashtu siç parashihet në nenin 6 të Aneksit VIII të kësaj zgjidhjeje. (Pakoja e Ahtisaar-it, 2007 b, Aneksi XI, fq. 64-65)
Në territorin e komunës aktuale të Mitrovicës do të krijohen dy komuna të reja, Mitrovica e Veriut dhe Mitrovica e Jugut, me kufij komunal të përcaktuar në shtojcën e këtij Aneksi III. Do të krijohet një bord i përbashkët i komunave të Mitrovicës Veriore dhe Mitrovicës Jugore, i cili do të zhvillojë bashkëpunim funksional në fushat e kompetencave të tyre, sipas marrëveshjes mes vetë komunave. (Pakoja e Ahtisar-it, 2007 c, Aneksi III, fq. 35)

Për Lëvizjen Vetëvendosje, pak a shumë, kjo do të thoshte:

Përfaqësja e një pakete të tillë u jep të drejtën serbëve për krijimin e njëmbëdhjetë mini-komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës, duke u dhënë mundësinë për të krijuar struktura zyrtare paralele me Serbinë, dhe bashkimi i këtyre mini-komunave me njëra-tjetrën do të çojë në krijimin e enklavave serbe në veri të Kosovës, gjë e cila do të sjellë rrjedhimisht krijimin e një lloji federate të njësisve vendore serbe, duke pasqyruar dhe lidhjen vertikale me Serbinë. (Kurti, 3 Janar 2008 a)

Madje, duke qenë se lëvizja e lëvronte veprimtarinë e saj jashtë lëmit institucional dhe meqenëse kufijtë dhe institucionet ligj zbatuese të Kosovës kontrolloheshin nga faktorët ndërkombëtarë, zbatimi i kësaj pakete, sipas Lëvizjes Vetëvendosje, linte të kuptohej se mund të sillte jo vetëm shkëlqimin e sovranitetit të shtetit të Kosovës, por edhe mungesën e një pjesëmarrjeje të vërtetë në hapësirën e jetës politike, aq më tepër kur “vetëm 37% e qytetarëve kanë votuar në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2007 dhe ku Hashim Thaçi bëhet Kryeministër vetëm me 104.000 vota” (Kurti, 2 Dhjetor 2010 b). Kjo ecuri mund të përfaqësojë pretendimin se diskutimet politike përfshijnë jo vetëm ndeshjen e partive politike rreth ndikimeve në hapësirën publike, por edhe përcaktimin e kushteve të veçanta për ndërhyrjet e qëllimshme të qeverisë, qoftë shqetësuese ose të përgjegjshme, përdorimin e mjeteve legjitime nga qeveria dhe diktimin e objektivave përfundimtarë ndaj çdo ndërhyrjeje jo-institucionale (Stone, 1997 a). Me sa duket, pjekja e këtyre dy kushteve diktuese e shtyu Lëvizjen Vetëvendosje që të injoronte çfarëdolloj bisedimi dhe vendimmarrje që shkonte në inkurajimin e kësaj linje politike, sepse politikat madhore (si kombëtare ashtu edhe publike), siç thotë edhe Burstain (1991), kontrollohen nga monopolet politike të cilat përbëhen nga një rrjet i grupeve dhe individëve që operojnë brenda dhe jashtë qeverisë, dhe që lidhen nga njohje të ndërsjella të cilat kanë të bëjnë me një grup të veçantë politikash.

Në një farë mënyre, kjo do të thotë se ashtu si përpjekjet për reforma, të artikuluar nga jashtë këtyre institucioneve qendrore (nga Vetëvendosje për shembull), mund të injorohen lehtësisht po ashtu edhe shfaqja e një konflikti midis këtyre aktorëve çon në krijimin e një e një ngërçi, i cili prodhon vetëm ndryshime anësore në fushën e politikave publike (Baumgartner Jones, 1993). Rrjedhimisht, kjo bëri që veprimtaria e kësaj lëvizjeje të gjendej e ngërthyer si nga presione të jashtme ndërkombëtare, ashtu edhe nga ndikime të brendshme politike, gjë që do t'i linte rrjedhë, ose vazhdim të reagimit të ashpër ndaj këtyre vendimmarrjeve, ose respektimit dhe pranimit të këtyre nismave, pranimi i të cilave do të nënkuptonte dështimin e vetë lëvizjes. Midis këtyre dy alternativave të “ofruara” asokohe, Vetëvendosje zgjodhi rrugën e parë, megjithëse, fillimisht, ndërmarrja e një veprimtarie kundërshtuese të pakthyeshme ndaj UNMIK-ut dhe aktorëve politikë kosovarë, do duhej të përqendrohej në kontekstin e ecurive dhe zhvillimeve të ndryshme brenda vendit dhe jashtë tij, pasi duke qenë se procesi lëvizjes sfiduese në shkallë të gjerë karakterizohet kah ndërtimi i rrjeteve dhe koalicioneve midis grupeve dhe individëve, që nuk veprojnë në sinkron me njëri-tjetrin, është e rëndësishme që të merren parasysh rrethanat në të cilat ka të ngjarë që të bashkëpunojnë aktorë të ndryshëm (McAdam, 1982).

Kështu pra, përshtatja e një taktike të tillë, e cila thekson lidhjen midis politikës qendrore, politikës publike dhe kundërshtisë politike (Tilly, 1978), nuk u realizua në atë moment, duke sjellë si rezultat vrasjen e dy veprimtarëve të lëvizjes kah forcat

ndërkombëtare, gjatë protestës së 10 Shkurtit të vitit 2007-të, dhe arrestimin e vetë Liderit dhe shumë veprimtarëve të tjerëve, çka do të thotë se reformat politike mund të ndodhin si rezultat i ndryshimit të balancës së pushtetit politik brenda këtij monopoli të trefishtë.

E drejta e tubimit, liria e shprehjes dhe ajo e lëvizjes na janë akorduar sipas Deklaratës Universale të të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, në nenin 20 dhe në Paktin Ndërkombëtar të të Drejtave Politike dhe Civile, neni 21. Shkelja e këtyre dhe e të drejtave të tjera, për hatër të interesave apo leverdisë politike, është e papranueshme. Në demonstratën e 10 shkurtit këto të drejta na janë mohuar kolektivisht. Kurse në rastin tim më janë mohuar individualisht të drejta universale njerëzore. (Kurti, Procesi gjyqësor kundër Albin Kurtit 2007-2008)

Kështu do të shprehej Albin Kurti në një kah seancat e daljes në gjyq pas arrestimit të tij. Pavarësisht se është e papranueshme moralisht dhe njerëzisht që të vriten protestues në mes të rrugës dhe të paarmatosur, ajo që vlen për monopolet e pushteteve qendrore ka të bëjë me çështjen se për aq sa lëvizje të tilla reflektojnë dhe krijohen jo vetëm në sajë të njohjes dhe theksimit të problematikave të caktuara, por edhe në sajë të personave që kundërshtojë të tilla problematika (Schneider dhe Ingram, 1997 b), atëherë duhet të izolohej veprimtari dhe veprimtarë të tillë, qoftë nëpërmjet arrestimit apo asgjësimit fizik të tyre, qoftë edhe nëpërmjet blerjes së jetëve të humbura, ku në një letër dërguar avokatit të njërit prej veprimtarëve të vrarë, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së thekson:

Në letrën tuaj të 27 gushtit 2009 drejtuar Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, të cilin ia ka përcjellë Bordit për Zhdëmtime, ju deklaroni se ende do të vazhdoni të ndiqni ankesën tuaj te Paneli Këshillues për të Drejtat e Njeriut për hetim të plotë penal. Ne ju njoftojmë se si kusht për pagesën e dëmshpërblimit, dhe në përputhje me procedurat standarde të Kombeve të Bashkuara, nga ju do të kërkohet të nënshkruani një dokument detyrues që e liron UNMIK-un dhe Kombet e Bashkuara prej çfarëdo detyrimi tjetër ndaj personave në ngarkim që rrjedh nga vdekja e Arben Xheladinit. (Procesi gjyqësor i panelit këshillues për të drejtat e njeriut)

Kjo për faktin se “veprimet shtypëse mund të përcaktohen si legjitime kah ana e shtetit” (Miller, 1999, fq. 305), pasi një kundërpërgjigje e tillë krijon pengesa politike, shoqërore dhe psikologjike ndaj angazhimeve aktuale ose të mëpasshme të lëvizjeve të tilla. Ndonëse mund të konsiderohet si e paimagjinueshme ndërmarrja e një veprimi të tillë kah forcat ndërkombëtare, për Lëvizjen Vetëvendosja kjo nënkuptonte domosdoshmërinë për krijimin e një përshtatjeje që kishte të bënte me përmirësimin e ndërlidhjeve vepruese midis aktorëve të brendshëm (në kuptimin e institucionalizimit brenda sistemit politik të lëvizjes) dhe të jashtëm politikë, me qëllim për të vijuar sa me shtrirjen më të gjerë të lëvizjes në sferën socio-politike dhe kulturore, po aq dhe me thellimin e ndikimit që duhet të ketë lëvizja në bashkërendimin e marrëdhënieve midis aktorëve të kudogjendur.

Kthimi i lëvizjes në parti dhe funksionimi zgjedhës-lëvizje

Përballja e lëvizjes me kundërpërgjigjen e drejtpërdrejtë të dhënë nga forcat ushtarake të UNMIK-ut më 10 Shkurt të vitit 2007-të, pasojat e së cilës u shoqëruan jo vetëm me vrasjen e dy veprimtarëve të lëvizjes në mes të rrugës, por edhe me arrestimin dhe burgosjen e udhëheqësit dhe disa veprimtarëve të tjerë aktivë të kësaj lëvizjeje, siç mund të ketë ndikuar drejtpërsëdrejti në funksionimin dhe mbarëvajtjen e vetë lëvizjes, po aq mund të ketë nxitur dhe pakënaqësinë ndaj këtyre forcave. Kjo nënkupton se qëllimi thelbësor i forcave ushtarake të UNMIK-ut mund të ketë qenë ose paralizimi dhe shpërbërja e vetë lëvizjes, ose testimi krahasues i burimeve dhe aftësive vepruese të forcave ndërkombëtare ndaj lëvizjes sitë tillë, për të dhënë indirekt një farë paralajmërimi në lidhje me ndryshimin e objektivave dhe taktikave vepruese të lëvizjes, pasi nuk ka se si të shpjegohet ndryshe fakti se “gjatë dhjetë muajve të mbajtjes në burg, Albini u mor vetëm një herë në pyetje për tridhjetë minuta”, ndërsa “ishte shumë e qartë që për UNMIK-un, në rastin e Albinit, prioritet më i madh qe izolimi i tij sesa e vërteta apo drejtësia” (Procesi gjyqësor kundër Albin Kurtit 2007-2008 a). Megjithatë, shumë pak kohë pas daljes së tij nga burgu, faktori ndërkombëtar vendosi që Kosova, mbi bazën e paketës së Ahtisarit, të shpallej një shtet i pavarur, pavarësisht mosnjohjes juridike që i bëri Rusia në Kombet e Bashkuara, duke sjellë kështu, në një farë mënyre, jo vetëm mospërfilljen e çështjes mbi të cilën Lëvizja Vetëvendosja zhvilloi veprimtarinë e saj, por shpalosi njëkohësisht dhe një mjedis të ri kushtesh dhe premisash rrethuese. Përcaktimi i një axhende të tillë politike nga ana e ndërkombëtarëve dhe arrestimi sërish i Liderit të Vetëvendosjes dhe disa drejtuesve të saj kah Qeveria e Kosovës më 12 Qershor të 2010-ës-, arrestimi i të cilëve “ndodhi pas konferencës për shtyp, në të cilën Lëvizja VETËVENDOSJE! bëri publik vendimin e vetë për të marrë pjesë në zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, si lëvizje” (Fletushkë e Lëvizjes Vetëvendosje, Nr. 202, 13 Qershor 2010), -, duket se i dha shtysë të mëtejshme vetë lëvizjes për ta konkretizuar në vendimmarrje një gjë të tillë, ku thuhet:

ne kemi vendosur të marrim pjesë në zgjedhje pas debatit demokratik që kemi zhvilluar brenda Lëvizjes për pesë muaj. Kjo nuk do të thotë se do të bëhemi parti politike. Assesi. Ne do të mbetemi lëvizje politike me të njëjtin objektiv dhe pjesëmarrja në zgjedhje është një metodë më shumë (Fletushkë e Lëvizjes Vetëvendosje, Nr. 204, 25 Qershor 2010)

Kjo do të thotë se në ndryshim nga partia, trajektorja e gjerë e lëvizjes lejon përfshirjen e lëvizjes, si brenda institucionit qendror apo lokal, po ashtu edhe lëvizjen e ndodhur jashtë institucioneve shtetërore (Meyer, 1990). Pak a shumë, një situatë e

tillë ka të bëjë me neutralizimin e zhvillimit të betejave politike jo-sistematike dhe shndërrimin e ndeshjeve të tyre brenda një kuadri të ligjshëm kushtetues, ku një zhvendosje e tillë e kursit taktik është parë si e domosdoshme jo vetëm për gjallimin e lëvizjes nga të dyja kahet, duke lehtësuar peshën e presionit të drejtpërdrejtë që ishte ushtruar më parë nga ndërkombëtarët dhe aktorët e brendshëm politikë, por edhe si e domosdoshme për shtimin e mundësive që shkojnë në funksion të përmbushjeve të qëllimeve të saj. E gjitha kjo merret në konsideratë vetiu, për shkak se një lëvizje shoqërore është më e madhe sesa një ndodhi e veçantë, dhe paraqitja e saj mbart një sfidë të shtrirë në kohë, pasi një lëvizje operon në një farë mënyre me anë të një ndërveprimi dinamik në lidhje me politikën qendrore (Meyer, 1990 a).

Mirëpo, pyetja e menjëhershme që vjen në këto momente qëndron në këtë pikë shikim:

a mund të ekzistojnë më lidhjet e drejtpërdrejta midis përmbajtjes dhe objektivave që shpaloste Lëvizja që më parë, me përmbajtjen dhe qëllimet që e karakterizojnë tanimë atë si një lëvizje e përfaqësuar politikisht?

Kjo, për vetë faktin se mund të shfaqet një përpjekje për të zhvilluar një lëvizje taktike të brendshme, që mund të shmangë gradualisht qëllimet themelore mbi të cilat u krijua kjo lëvizje. Mundësia e shfaqjes së një prirjeje të tillë, siç nxit kundërshtimet e aktorëve kryesorë dhe mbështetësve, që iu besojnë thelbësisht qëllimeve dhe kauzës së lëvizjes, ndaj kësaj prirjeje, po aq mund të ndikojë edhe tek mbështetësit e tjerë për të zbehur natyrën domethënëse dhe vepruese në lidhje me kauzën e lëvizjes. Parashtrimi i një hamendësimi të tillë, vuri në dukje konfigurimin e lëvizjes përgjatë një ecurie, e cila mbart në organizimin e saj jo vetëm funksionimin për arritjen e çështjeve të shfaqura që në themelimin e saj, por edhe përpjekjen për përforcimin e vetë lëvizjes, ku në hapjen e fushatës zgjedhore dhe në zhvillimin e procesit zgjedhor në Dhjetor 2010-ës thuhej:

Nuk mund të bashkohemi pa e bashkuar Mitrovicën. Duam shtet të ri për kombin shqiptar, e jo komb të ri për shtetin e Kosovës. Qytetarë të Kosovës. Procesi zgjedhor filloi problematik në disa prej Qendrave të Votimit, por disa probleme janë zgjidhur dhe janë marrë masa pas reagimeve të njëpasnjëshme të Lëvizjes VETËVENDOSJE! Ne jemi duke e monitoruar imtësisht procesin, në secilën qendër e në secilin vendvotim, dhe duke raportuar edhe për shkelje më të vogla, dhe të parandalojmë shkeljet e mëdha. (Lëvizja 2010- Pjesa e katërt, 29 Dhjetor 2010).

Përfundimi i zgjedhjeve të 2010-ës, duke u përqendruar në këto dy kategori bazike, rezultoi me fitimin e 12 vendeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës, duke parashtruar hedhjen e vështrimit mbi dy parametra të dallueshëm thelbësorë të cilët kanë të bëjnë me autoritetet dhe mbështetësit. Njëri nga parametrat shërben si një objektiv për të patur dhe rritur ndikimin, potë kemi parasysh kur një drejtuese e saj shprehet se “deklaratat e ministrit Jabllanoviç, që i quan nënat e të zhdukurve dhe protestuesit në Gjakovë egërsira, ishin deklarata tipike të një kolonizatori, i cili përmes deklaratave të tilla, mundohet ta justifikojë pushtimin dhe të gjitha krimet që ka bërë shteti i Serbisë në Kosovë” (Rusta, 16 janar 2015, Aksioni pranë Ministrisë për Komunitete dhe Kthim). Ndërkohë që tjetri shërben si një premisë për të shtuar burimet vepruese, kur artikullohet se “shteti patjetër duhet të shpenzojë për të varfrit dhe t’i tatojë të pasurit. Mirëpo, në Kosovë bëhet e kundërta. Sistemi i shfrytëzohet dyfish të varfrit: individualisht me kamata të larta të kredive dhe kolektivisht me tatime jo progresive” (Kurti, 30 dhjetor 2014, Barra e njeriut të varfër). Duke qenë se këto dy emërtime ushtrojnë presione mbi grupet e ndryshme shoqërore, mbi ata që i mbështesin dhe ata që nuk i mbështesin këto politika të mësipërme (meqenëse vetë Kryeministri i Kosovës nuk reagoi publikisht ndaj ministrit serb që bëri deklarata të tilla), atëherë lipset nevoja për të lehtësuar peshën e ushtrimit të këtyre presioneve duke e mbështetur lëvizjen dhe garën e mëtejshme politike në një program të shkruar politik, shpallja e të cilit jo vetëm që krijon një lidhje fillestare përgjegjshmëria dhe serioziteti ka përfaqësuesit për mbështetësit dhe jo mbështetësit e tyre politikë, por legjitimon dhe filluesën e një besueshmërie për vetë drejtuesit e lëvizjes, aq më tepër kur shkruhen në program ato çfarë janë thënë dhe më parë në një rrafsh gjithëpërfshirës, si p.sh.:

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet për ndryshim të pjesëve të Kushtetutës së Kosovës të cilat e kufizojnë sovranitetin e shtetit të Kosovës përfshirë këtu heqjen e Planit të Ahtisaarit, që e ndan territorin, institucionet dhe kulturën mbi baza etnike, ndërkohë që përjetëson sundimin ndërkombëtar mbi Kosovën (Program i shkurtër politik, Shtet ndërtimi, fq. 7).

E shpallur në këtë mënyrë, kjo i bën përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosja të mbështeten në idenë se nëse grupet bashkëpunojnë mbi qëllimet dhe taktikat, ata mund të maksimizojnë ndikimin e tyre tek politikë bërësit (Zald dhe McCarthy, 1987), çka nënkupton sa rritjen e mbështetësve të tyre nëpërmjet pohimit të simbolikave me karakter kombëtar, po aq edhe rritjen e ushtrimit të presionit tek partitë që janë në pushtet qeverisës. Mirëpo, përgjatë kësaj ecurie rrjedhash shprehëse dhe vepruese nevojitet edhe ruajtja e qëndrueshmërisë brenda vetë anëtarëve dhe mbështetësve të Lëvizjes, duke u shprehur se “ratifikimi i marrëveshjes Thaçi-Daçiq është dëm me vulë. Pra, dëmin që po ia shkakton kjo marrëveshje Kosovës, synojnë t’ia vënë vulën e Kuvendit të Kosovës. Kësisoj, Thaçi e shpërndan përgjegjësinë e tij edhe tek deputetë të LDK-së e AAK-së, si dhe e degradon Kuvendin e Republikës në një Kuvend të Qeverisë pa Republikë” (Kurti, 18 Qershor 2013, Sheshazi kundër ratifikimit). Kjo do të thotë se ata mund të ndryshojnë vetët e tyre nga grupet e tjera, sepse secili prej grupeve përpiket të krijojë dhe përmirësojë hapësirën vetjake për rritjen e mbështetjes (Zald dhe McCarthy, 1987 a). Megjithatë, njohja dhe vënia në qendër të vëmendjes e shumë problematikave të nevojave të jetës së përditshme kah drejtuesit e Lëvizjes Vetëvendosja - të cilat kanë të bëjnë me interesin publik- u jep mundësinë, nga njëra anë, grupeve të ndryshme shoqërore që t’i drejtojnë kërkesat e domosdoshmërive të tyre jetike për kah institucionet qeverisëse që nuk kanë realizuar pritshmëritë jetike të qytetarëve, duke theksuar: “zyra e Rregullatorit të Energjisë ka marrë vendim që ta ngrëjë çmimin për të gjitha blloqet e tarifave të energjisë

elektrike për 5.18%. Kjo rritje vjen pas ngritjes së mëhershme të çmimit për 4.57%, vendim ky që u arrit në korrik të këtij viti. Pra, dy herë radhazi kemi ngritje të çmimit të energjisë elektrike në Kosovë” (Privatizimi i KEDS – Çmim më i shtrenjtë për më pak furnizim me energji, 03 Shtator 2014).

Nga ana tjetër, vënia në dukje e drejtuesve të lëvizjes të mos përbushjes së nevojave jetike të qytetarëve kah ana e qeverisë, parashtron jo vetëm zhveshjen nga identifikimet personale dhe formale të lëvizjes në lidhje me mbështetësit dhe zgjedhësit e partive të ndryshme dhe partive në pushtet, por përqsas aty për aty mbështetjen dhe afrimin e mundësisë për zgjidhjen e problemeve të tilla, ku “ata që kanë të ardhura ose fitim mujor deri në 170 euro, nuk do të taten fare; për pagat nga 170 e deri 500 euro (përafërsisht trefishi i pagës minimale), tatimi në të ardhura duhet të jetë 5%; për pagat nga 500 deri në 850 euro (pesëfishi i pagës minimale), tatimi në të ardhura duhet të jetë 10%; për pagat nga 850 deri në 1700 euro (dhjetëfishi i pagës minimale), tatimi në të ardhura duhet të jetë 20%; kurse për pagat mbi 1700 euro (mbi dhjetëfishin e pagës minimale) tatimi në të ardhura duhet të jetë 30%. Sa për ilustrim, në Gjermani, ata që kanë mbi 250.000 mijë euro të ardhura në vit, paguajnë deri në 45% tatim!” (Kurti, 09 Prill 2014, Taksimi progresiv zbut pabarazinë).

Ravijëzimi politik i vetë lëvizjes në një sens sa më të gjerë publik, ndërsa theksohet se “jemi kundër privatizimit të ndërmarrjeve publike dhe pasurive strategjike të Kosovës të cilat kanë potencial përfitimi dhe janë baza ekonomike e vendit” (Publikime/Dokumente, Program i shkurtër politik: Privatizimi), konfirmon thelbësisht, nga njëra anë, artikulet e bëra edhe gjatë kohës që ajo nuk ishte e institucionalizuar në sistemin politik, pasi, parë në këtë këndvështrim, Publikja mund të konsiderohet si paradhoma e Bashkimit Kombëtar. Nga ana tjetër, ndërlidhja e specifikave të jetës së përditshme me gjithë përfshirjen publike, e ndihmon Lëvizjen Vetëvendosje jo vetëm për shtimin e burimeve në njerëz dhe aftësi njerëzore, por edhe për të përmirësuar mbështetjen e tyre institucionale me qëllim, siç theksojnë Piven dhe Cloëard (1977), për ndjekjen e pretendimeve përgjatë një kohe afatgjatë, pasi grupeve të ndryshme shoqërore u nevojitet një infrastrukturë për angazhimin mëtejshëm (Minkoff, 1995), po të kemi parasysh se grupet kanë më tepër mundësi të ndryshojnë kur zvetënohet interesi publik, duke çuar kështu në ndjekjen e elementëve të ndryshëm për çështjet e interesuara (Meyer dhe Douglas, 1993 a).

Ndërkohë, ajo që është e rëndësishme për vetë lëvizjen lidhet edhe me përgatitjet që ajo ka bërë për ruajtjen dhe përmirësimin e marrëdhënieve me aktorët ndërkombëtarë që kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe që theksojnë thellimin e disa problematikave në sektorët ekonomikë, energjitikë dhe arsimorë për të cilat, ashtu sikurse ka rënë dakord edhe vetë Lëvizja Vetëvendosje, kërkohet ndryshimi dhe përmirësimi i gjendjes në këta sektorë. Pritja dhe bisedimi me ambasadorët e Gjermanisë, Hollandës dhe Austrisë, dëftoi përkimin e qëndrimit midis Lëvizjes Vetëvendosje dhe Ambasadorëve në disa kah këto pika, si p.sh.:

Ambasadorja Viets u interesua mbi planet dhe aktivitetet e Lëvizjes VETËVENDOSJE! gjatë muajve në vijim, dhe shpjegoi se ndante të njëjtin shqetësim sa i përket sektorit energjetik në Kosovë, pasi edhe investitorët gjermanë e ngrënë çështjen e energjisë si një nga shqetësimet e tyre lidhur me Kosovën. (Takim me Ambasadorin e Gjermanisë, 01 Prill 2015)

Ambasadori Bosch ra dakord që një prej problemeve kryesore të Kosovës është punësimi, dhe që duhet të ketë një vëmendje të shtuar të shtetit për të stimuluar konsumin e prodhimit vendas. (Ambasadori i Hollandës pritet në takim në Lëvizjen VETËVENDOSJE!, 31 Mars 2015)

Ambasadori Brieger bëri urimet e tij për Kryesinë e re që ka dalë nga zgjedhjet e brendshme të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, dhe theksoi nevojën për rritjen e vëmendjes në problemet e arsimit dhe shëndetësisë në Kosovë. Ai theksoi nevojën për një qasje të re në ekonominë e Kosovës që do ta përmirësonte gjendjen në këtë drejtim. (Lëvizja Vetëvendosje! pret në takim Ambasadorin e Austrisë, 31 Mars 2015)

Po ashtu, Lëvizja Vetëvendosje ka mundur të rrisë bashkëpunimin politik edhe me aktorët e brendshëm politikë që janë në opozitë së bashku me të, duke bashkërenduar axhendat e tyre në zhvillime protestash të përbashkëta dhe të mbështetura në disa pika, të cilat theksojnë:

Të shfuqizohet vendimi i ZRrEE-së i datës 29 gusht 2014 dhe të shkarkohet Bordi i ZRrEE-së, Trepçatë shpallet me ligj ndërmarrje publike me status të veçantë, të shkarkohet Hajredin Kuqi, të dorëhiqet Enver Hasani, të shkarkohet menaxhmenti i RTK-s. (Nga takimi i liderëve të subjekteve opozitare lidhur me protestën e 18 Prillit 2015, 08 Prill 2015)

Kjo do të thotë se institucionalizimi, si në përmbajtje ashtu edhe në procedurë, përshkruan rrugët se si mund të arrihet ndryshimi në rrafshin e politikës, pa i bërë bisht dhe pa e shuar kauzën mbi të cilën themelohet një lëvizje, sepse kur vëmendja e publikut tërhiqet më së tepërmi për kah një çështje dhe kur burimet që përdoren për atë çështje janë krahasueshmërisht të vlefshme, thekson Benford (1993 b), atëherë ndodh që grupet të bashkëpunojnë midis tyre, madje dhe grupet të cilat nuk kanë një interes fillestar për atë çështje, ka të ngjarë për ta zhvilluar atë.

Përfundime/Sugjerime

Zakonisht, jo vetëm në lëmin e Shkencave Ekzakte dhe të Fizikës, por edhe në fushën e Shkencave Shoqërore, bërja e një studimi sa më të mbarëvajtshëm teorikisht dhe metodikisht, i bëjnë udhë vijueshmërisë së mendimit ideor dhe atij praktik, i cili mbart në domethënie të tij më të natyrshme hapjen dhe krijimin e disa mundësive dhe udhëve që do të shërbejnë sa

për njohjen, kuptimin, përjasjen apo përballjen me problematikat e reja që mund të lindin, po aq edhe për të konfiguruar një botëkuptim më të përgjithshëm dhe më të qëndrueshëm në përmbajtje të ecurive sa më të shëndetshme të sensit të Shoqërisë dhe të Qytetarisë në përgjithësi. Parë në këtë prizëm, edhe ky studim shkencor mëtoi të paraqiste një tablo sa më të qartë dhe të kuptueshme të asaj se pse është e nevojshme dhe e domosdoshme, për vetë Shoqërinë, prania dhe veprimtaria socio-politike, si e Lëvizjes shoqërore po ashtu edhe e Partisë politike. Vënia në garë e këtyre dy njësive në rrafshin e socio-politikës, pa dyshim që i bën udhë shpalosjes, konkurrimit dhe përzgjedhjes së alternativave që shkojnë në favor të mirëqenies më të mirë përgjithësisht dhe që është më e qëndrueshme në kohë. Nëse arrihet të përvetësohet sensi i përgjegjshmërisë dhe përgjegjshmërisë së Lëvizjeve shoqërore dhe Partive politike kah kërkesat e zgjedhësve dhe mbështetësve të tyre dhe më tej, ashtu sikurse ky punim shkencor u rrek të dëftonte, kjo do të thotë se vënia në pah e programeve të tyre socio-politike, apo qoftë edhe kundrejt njëri-tjetrit, nuk ka të bëjë thjesht me përplasje idesh dhe veprimesh kundërshtuese që përjashtojnë njëri-tjetrin, por, anasjelltas, lidhet me përcaktimin e qartë të idesë për të formuluar verbalisht dhe për të vepruar konkretisht, për aq sa artikulimi apo programi i tyre politik ua dëfton në ligjërimin e tyre apo të shkruar në letër. Qëndrimi i puqshëm midis artikulimit programor dhe veprimit për përmbushjen e tij, duke mirëkuptuar këtu edhe ndonjë mospërmbushje të kërkesave dytësore të zgjedhësve apo mbështetësve, për shkak të ndërhyrjes së faktorëve të pallogaritshëm subjektiv, objektiv dhe rrethanor, arrin të ravijëzojë një lidhje në përpjesëtim të drejtë midis Lëvizjes dhe Partisë, nga njëra anë, dhe zgjedhësve dhe mbështetësve të tyre nga ana tjetër. E rëndësishme është që pasi të jenë përmbushur të tilla domethënie përgjegjshmërie dhe përgjigjshmërie, zgjedhësit dhe mbështetësit përgjithësisht të jenë të plotësuar dhe të përvetësuar në kërkesat e tyre themelore, me qëllim që të ndihen si aktorë dhe faktorë të drejtpërdrejtë të erërave të ndryshimit socio-politik.

Bibliografia

- Baumgartner, F. R. & Jones, B. D. (1993). *Agendas and Instability in American Politics*. Chicago: Chicago University Press.
- Benford, R. D. (1993b). Frame Disputes within the Nuclear Disarmament Movement. *Social Forces* 71, pp. 677-701 New York: Routledge.
- Burstein, P. (1991). Policy Domain: Organization, Culture, and Policy Outcomes. *Annual Review Of Sociology* 17, Minneapolis:Minnesota University Press.
- Christiansen, J. (2011). *Theories of Social Movements*. Pasadena, California: Salem Press.
- Gamson, W. A. & Mayer, D. S. (1996). Framing political opportunity. In McAdam, D. & McCarthy, J. D. & Zald, M. N. (Eds.), *Comparative perspectives on social movements: Political opportunities, mobilizing structures, and cultural framing* (pp. 275-90). Cambridge, MA: Cambridge University Press.
- McAdam, D. (1982). *Political Process and the Origins of Black Insurgency*. Chicago: Chicago University Press.
- Meyer, D. S. (1990, a). *A Winter of Discontent: The Nuclear Freeze and American Politics*. New York: Praeger.
- Meyer, D. S. & Douglas, I. R. (1993a). Political Opportunity and the Rise and Decline of Interest Group Sectors. *Social Science Journal* 30, pp. 253-70. New York: Grosset & Dunlap.
- Meyer, D. S. & Rochon, T. R. (1997). Toward a Coalitional Theory of Social and Political Movement. In Rochon and Meyer (Ed.), *Coalition and Political Movements: The Lesson of Nuclear Freeze* (pp. 237-52). Boulder Co: Lynne Rienner.
- Miller, F. D. (1999). The end of SDS and the emergence of Weatherman: Demise through success. In J. Freeman & V. Johnson (Eds.), *Waves of protest: Social movements since the Sixties* (pp. 303-24). Lanham, Maryland: Rowman & Littlefield Publishers.
- Minkoff, D. C. (1995). *Organizing for Equality: The Evolution of Women's and Racial-Ethnic Organizations in America, 1955-1985*. New Brunswick, NJ: Rutgers University Press.
- Piven, F. F. & Cloward, R. A. (1977). *Poor People's Movements*. New York: Vintage.
- Schneider, A. L. & Ingram, H. (1997 b). *Policy Design for Democracy*. Lawrence: Kansas University Press.
- Stone, D. (1997 a). *Policy Paradox: The Art of Political Decision Making*. New York: Norton.
- Tarrow, S. (1998). *Power in Movement: Social Movements and Contentious Politics*. Cambridge 2nd ed.,: Cambridge University Press.
- Tilly, C. (1978). *From Mobilization to Revolution*. Massachusetts: Addison-Wesley.
- Toch, H. (1965). *The Social Psychology of Social Movements*, Indianapolis, IN: Bobbs-Merrill
- Zald, M. N. & McCarthy, J. D. (1987). *Social Movements in an Organizational Society*. New Brunswick, NJ: Transaction.

Burime nga interneti

- Ambasadori i Hollandës pritet në takim në Lëvizjen Vetëvendosje! (31 Mars 2015). Marrë kah www.vetevendosja.org/Lajme.
- Historiku i Lëvizjes Vetëvendosje. Marrë kah www.vetevendosja.org/Publikime/Dokumente.
- Fletushkë e Lëvizjes Vetëvendosje, Nr. 202, (13 Qershor 2010). Arrestohet Albin Kurti. Marrë kah www.vetevendosja.org/Publikime/Fletushka.
- Fletushkë e Lëvizjes Vetëvendosje, Nr. 204, (25 Qershor 2010). Pse ka vendosur Lëvizja Vetëvendosje të marrë pjesë në zgjedhje. Marrë kah www.vetevendosja.org/Publikime/Fletushka.
- Nga takimi i liderëve të subjekteve opozitare lidhur me protestën e 18 Prillit 2015, (08 Prill 2015). Marrë kah www.vetevendosja.org/Lajme.
- Pakoja e Ahtisaar-it (26 Mars 2007). Aneksi IX, Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, Neni 2/1, pika a. Marrë kah www.vetevendosja.org/Publikime/dokumente.
- Pakoja e Ahtisaar-it (26 Mars 2007). Dispozitat e përgjithshme, Neni 1/7&8. Marrë kah www.vetevendosja.org/Publikime/dokumente.
- Kurti, A. (30 dhjetor 2014). Barra e njeriut të varfër. Marrë kah www.vetevendosja.org/Publikime/Shkrimet.
- Kurti, A. (2 Dhjetor 2010, a, b). Intervistë e realizuar me Albin Kurtin nga gazetari Blendi Fevziu në emisionin Opinion. Marrë kah www.vetevendosja.org/VideoGaleria.

- Kurti, A. (3 Janar 2008, a). Intervistë e dhënë për rrjetin mediatik BBC. Marrë kah www.vetevendosja.org/ Video Galeria.
- Kurti, A. *Procesi gjyqësor kundër Albin Kurtit 2007-2008*. Marrë kah www.vetevendosja.org/ Rasti i 10 Shkurtit.
- Kurti, A. (18 Qershor 2013). Sheshazi kundër ratifikimit. Marrë kah www.vetevendosja.org/ Publikime/Shkrimet.
- Kurti, A. (09 Prill 2014). Taksimi progresiv zbut pabarazinë. Marrë www.vetevendosja.org/ Publikime/Shkrimet.
- Lëvizja 2010- Pjesa e katërt (29 Dhjetor 2010). Marrë kah www.vetevendosja.org/ Lajme.
- Lëvizja Vetëvendosje! pret në takim Abasadorin e Austrisë (31 Mars 2015). Marrë kah www.vetevendosja.org/ Lajme.
- Pakoja e Ahtisaar-it (26 Mars 2007). Aneksi XI, Prania Ushtarake Ndërkombëtare, Neni 1/3&4, fq.64-65. Marrë kah www.vetevendosja.org/ Publikime/dokumente
- Pakoja e Ahtisaar-it (26 Mars 2007). Aneksi III, Decentralizimi, Neni 13/1&2, fq. 35. Marrë kah www.vetevendosja.org/ Publikime/Dokumente.
- Privatizimi i KEDS – Çmim më i shtrenjtë për më pak furnizim me energji (03 Shtator 2014). Marrë kah www.vetevendosja.org/ Lajme.
- Procesi gjyqësor i panelit këshillues për të drejtat e njeriut. Marrë kah www.vetevendosja.org/, Rasti i 10 Shkurtit
- Procesi gjyqësor kundër Albin Kurtit 2007-2008 a. Marrë kah www.vetevendosja.org/ Rasti i 10 Shkurtit. Program i shkurtër politik: Shtet ndërtimi. Marrë kah www.vetevendosja.org/ Publikime/Dokumente.
- Rusta, T. (16 janar 2015). Aksioni pranë Ministrisë për Komunitete dhe Kthim: Këtu punon një fashist!. Marrë kah www.vetevendosja.org/ Lajme.
- Takim me Ambasadorin e Gjermanisë (01 Prill 2015). Marrë kah www.vetevendosja.org/ Lajme.

DEMOKRATIZIMINËPËRMJETZGJERIMIT: NJËSTUDIMKRAHASIMORMIDISBOSNJE HERCEGOVINËS DHE KOSOVËS

STILIANO RUSHAJ

Universiteti Europian i Tiranës, Shkolla Doktorale, Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare

ABSTRAKT

Prej më shume se 20 vite tranzicioni për vendet ish-komuniste të Ballkanit Perëndimor, demokratizimi mbetet një sfidë e pa përmbushur ende. Kjo sfidë qëndron si në aspektin implementues ashtu dhe në atë konsolidues. Ndër karakteristikat e njëjta që këto vende ndajnë si në të shkuarën ashtu dhe në të tashmen - disa prej tyre vijnë nga një eksperiencë post-konfliktuale – e cila i ka krijuar vështirësi më të mëdha në procese që lidhen së pari me shtetformim dhe paqim e më pas të rendin drejt demokratizimit.

Sfida që vihet re dukshëm është forcimi i zbatimit të ligjit e cila ka një influencë të drejtpërdrejt në mbrojtjen dhe rritjen e lirive civile në secilin vend. Ndërkaq duke marrë në konsideratë përfshirjen e BE si aktori kryesor në promovimin e demokracisë në rajon, do të kërkoj të hulumtoj si ndikon procesi i Zgjerimit, nëpërmjet kushtëzimit politik, të influencojë forcimin e demokratizimit në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kosovë? Nëpërmjet një analize institucionale e parë nga raportimet vjetore të BE dhe e suportuar nga vlerësimet dhe raportet e organizatave joqeveritare ndërkombëtare do të përpiqem të ofrojë një vështrim analitik dhe krahasues në dy rastet respektive. Argumenti kryesor që do të kërkojë të mbështet mbi këtë hulumtim të dhënash do të shtrohet se: Edhe pse BE e shton presionin shtrëngues nëpërmjet Kushtëzimit në lidhje me forcimin e zbatimit të ligjit dhe zgjerimit dhe mbrojtjes së të drejtave civile, demokratizimi në vendet post-konfliktuale mbetet stagnues. Në këtë artikull së pari do të analizojë një vështrim teorik mbi demokratizimin, nëpërmjet perspektivës të zgjerimit Evropian. Më pas në pjesën e dytë do të analizoj Kushtëzimin e BE ndaj dy parametrave të demokratizimit në të dyja rastet studimore. Së treti do të zhvilloj një analizë krahasuese e cila do të përpiqet të argumentojë mbi mbrojtjen e supozimit që kam parashtruar në fillim.

Fjalë kyç: *Demokratizim, Zgjerimi i BE, Kushtëzimi, zbatimi i ligjit, liri civile*

Hyrje

Fundi i Luftës së Ftohtë, u shfaq me një të ardhme mbresëlënëse për përhapjen e demokratizimit midis ish-vendeve komuniste të Evropës Lindore. Ky tranzicion demokratik në vendet e Ballkanit Perëndimor, ndodhi me shpërbërjen e përgjakshme të disintegrimit të ish –Jugosllavisë dhe procesi i demokratizimit u zhvillua njëherazi me krijimin e shteteve të reja që së pari po kalonin një proces shtet-ndërtimi. Përfshirja e BE në rajon u pa si një perspektivë për të gjithë rajonin për të menaxhuar të ardhmen e saj, me një mirëqenie më të sigurt dhe të një demokracie të konsoliduar.

Sot ajo që shihet pas 10 vitesh angazhim i drejtpërdrejt të fillimit të procesit të Zgjerimit¹, demokratizimi i këtyre vendeve është sfiduar, për shkak të implementimit të ulët institucional të forcimit të zbatimit të ligjit dhe në të njëjtën mënyrë të zgjerimit të ulët të lirive civile. Kjo problematikë duket më se e qartë në dy nga vendet e rajonit: Bosnja dhe Hercegovina (këtej e tutje B&H) dhe Kosova. Procesi i tyre shihet i stagnuar dhe gjithashtu pritsmëritë e BE ndaj tyre kanë rënë dukshëm.

Duke marrë në konsideratë veçoritë e njëjta që këto shtete ndajnë, argumentoj se, edhe pse BE forcon presionin koerktiv(coercive) nëpërmjet Kushtëzimit në lidhje me forcimin e Zbatimit të Ligjit dhe zgjerimit të Lirive Civile, demokratizimi në vendet post-konfliktuale të EJL, qëndron stagnjettë.

Ky argument do të përdoret si vektori drejtues i këtij studimi. Në pjesën e parë do të analizojë backgroundin e demokratizimit, nga perspektive Evropiane e Procesit të Zgjerimit. Dhe më pas në pjesën e dytë do të analizojë Kushtëzimin e BE ndaj forcimit të Zbatimit të Ligjit dhe zgjerimit të lirive civile, së pari ndaj rastit studimor të B&H dhe me të njëjtën mënyrë ndaj Kosovës. Në pjesën e tretë në analizë krahasues midis rasteve do të prezantojë shpjegimet për pyetjen kryesore që ky punim kërkon të shpjegojë.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij punimi është të kuptojë përfshirjen e BE në procesin e demokratizimit në Bosnje Hercegovinë dhe në Kosovë gjatë procesit të tyre institucional dhe kontraktual të integritimit (MSA). Përzgjedhja e këtyre dy shteteve për ti nënshtruar një analizë krahasimore është bërë pasi, së pari ata ndajnë një të shkuar të njëjtë nga ish Jugosllavia: ish entitete post-konfliktuale të cilat nisën një proces paqëndërtimi me shtet-formim transformues më së shumti me drejtim të jashtëm e cila në një anë krijoi institucione themelore shtetërore e pranueshme për të gjithë aktorët e brendshëm dhe në anën tjetër për të nisur procesin e integritimit si vendet e tjera të rajonit. Ato së bashku kanë problem shtetit të dobët, ku për shembull B&H përballet me pasiguri për unitet (në nivel shtetëror) dhe Kosova që përballet me të njëjtën problematikë (pranimi i komunave serbe të rolit si qeveri qendrore të institucioneve të Prishtinës) dhe njohje ndërkombëtare. Kështu B&H ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit por ende ajo nuk ha hyrë në fuqi dhe Kosova në fillimin e MSA, të mbetura kështu si vendet e fundit e rajonit.

Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Ky punim kërkon të hulumtojë si ka ndikuar procesi i Zgjerimit, nëpërmjet kushtëzimit politik, të influencojë zgjerimin e demokratizimit në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kosovë? Duke marrë në konsideratë veçoritë e njëjta që këto shtete ndajnë, argumentoj se, edhe pse BE forcon presionin koerktiv(coercive) nëpërmjet Kushtëzimit në lidhje me forcimin e Zbatimit të Ligjit dhe zgjerimit të Lirive Civile, demokratizimi në vendet post-konfliktuale të EJL, qëndron stagnjettë.

Ky argument do të përdoret si vektori drejtues i këtij studimi. Në pjesën e parë do të analizojë backgroundin e demokratizimit, nga perspektive Evropiane e Procesit të Zgjerimit. Dhe më pas në pjesën e dytë do të analizojë Kushtëzimin e BE ndaj forcimit të Zbatimit të Ligjit dhe zgjerimit të lirive civile, së pari ndaj rastit studimor të B&H dhe në të njëjtën mënyrë ndaj Kosovës. Në pjesën e tretë në analizë krahasues midis rasteve do të prezantojë shpjegimet për pyetjen kryesore që ky punim kërkon të shpjegojë.

Nga një vështrim i përgjithshëm i gjendjes së literaturës, vëmë re se ka një numër mjaft të madh studimesh në lidhje me procesin e demokratizimit në vendet ish-komuniste apo ato post- konfliktuale. Ndaj ky punim do ta mbështes analizën e tij nga studimet e Schimmelfennig F., Sedelmeier U. dhe Tocci N.² Nga pikëpamja metodologjike ky punim do të përdor metodat cilësore dhe do të përdor si burime parësore nga progres-raportet e Komisionit Evropian ndër vite dhe nga të dhëna të Indeksit Demokratik të “the Economist”. Së pari progres-raportet e Komisionit Evropian do të japin më tepër insights në progresin e vendeve të bazuara në forcimin e zbatimit të ligjit dhe zgjerimit të lirive civile dhe së dyti ratinget e indekseve të demokracisë do të suportojnë argumentin se përse vendet kanë rezultate të ndryshme gjatë periudhës kohore që ky studim

Procesi i Zgjerimit nisi fill pas samitit të Selanikut në 2003, në të cilin shpalli zyrtarisht se vendet e Ballkanit Perëndimor kanë të ardhmen e tyre si vende antare të Bashkimit Evropian. Vendet duhet të kishin compliance së pari me kriteret e Kopenhagenit dhe më pas vendi do të kishte të drejtë të niste negociatën me Unionin. Përveç Kroacisë (2014), të gjitha vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor kanë një patur një rrugëtim të gjatë për të qënë së pari vende candidate. Në fakt Bosnje Hercegovina dhe Kosova ende janë në pro' esin për përfituar Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit dhe më pas to be eligible si kandidatë potencial.

Për lexime të mëtejshme ndaj përdorimit të kushtëzimit në pro' esin e zgjerimit të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore disa nga

autorët më kryesorë janë Schimmelfennig and Sedelmeier 2004; Tocci 2007.

merr në konsideratë. Kështu që, mund të themi se rëndësia që ky studim sjell është se kërkon të hulumtojë influencën e politikës së kushtëzimit që BE përdor ndaj procesit integruar të këtyre vendeve duke e vlerësuar me nivelin e demokratizimit në vendet respektive.

Demokratizimi nëpërmjet perspektivës së zgjerimit të BE

Në përgjithësi, demokratizimi është parë si një proces me dy komponentë kryesorë: reformimin e organizimit institucional, të tilla si formësimi i backgroundit politik që përshtatet me një sistem qeverisjeje demokratike dhe duke ndryshuar sjelljen për të respektuar normat e reja demokratike dhe liberale që shoqërojnë një regjim demokratik.³ Ndryshimet institucionale janë shpesh jo shumë të komplikuar (demokratizimin e institucioneve), por probleme vjen kur sjellja duhet të ndryshojë (demokratizimin e shoqërisë). Në të njëjtën mënyrë Ezelzel dhe Alexander shpjegojnë se demokratizimi duhet të shihet midis dallimit të demokracisë në terma nominalë dhe demokracisë efektive. Ata shpjegojnë se, “ekzistenca e të drejtave popullore” - në këtë punim merret si liritë civile – “përcakton demokracinë nominale por sundimi i ligjit është i nevojshëm për ta shndërruar nominalen në demokraci efektive”⁴. Nëpërmjet këtij vlerësimi, mund të kuptojmë se të drejtat civile dhe sundimi i ligjit ndërveprojnë për të krijuar atë masë të demokracisë efektive që një vend ka nevojë për të konsoliduar institucionet e saj demokratike dhe për të ndryshuar sjelljen në një shoqërie demokratike të afirmuar. Por më pas na duhet të kuptojmë se si mund të ndikojë një aktor i jashtëm të prodhojë mekanizma nxitëse për një demokratizim të mëtijshëm efektiv.

Bashkimi Evropian si një komunitet i bazuar në vlera, ka arritur deri diku të jetë e suksesshme në transmetimin e disa nga vlerat dhe normat e saj ndaj në vendeve e treta, por ky proces është i gjatë dhe i komplikuar.⁵ Nëpërmjet procesit të zgjerimit të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, kushtëzimi filloi të formësohej si një mjet për procesin e anëtarësimit të vendit të synuar, me qëllim të transformimit të strukturave të qeverisjes, ekonomisë dhe të shoqërisë civile të vendit (potencial) kandidat. Në kuptimin më të gjerë ky qëllim ka të bëjë me një strategji në të cilën një shpërblim ose jepet ose mbahet e kushtëzuar, në varësi të përbushjes së një kushti të paracaktuar. Më konkretisht, “kushtëzimi politik” është strukturuar si një lidhje kontraktuale, nga një shtet apo / dhe të organizatës ndërkombëtare, e një përfitimeve të perceptuara ndaj një shteti tjetër, i cili vihet në funksion me plotësimin e kushteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe avancimin e parimeve demokratike”⁶.

Kështu, kushtëzimi i BE-së është kuptuar si një dikotomi midis “karrotash dhe shkopinjeve”. “Karrota” nënkuptohen si një shpërblim për sjellje të mirë të shtetit, zakonisht duke filluar nga ndihma ekonomike e deri në anëtarësimin e plotë të tij. Në anën tjetër “shkopinjte” janë përdorur për të ndëshkuar një shtet të synuar për mos përputhje me kushtet e kontraktuar. Në këtë kuptim kushtëzim negativ përfshin shkaktimin e dënimit në një shtet të synuar për shkeljen e ndonjë detyrimi të specifikuar.⁷ Kjo mund të shpjegohet më tej nga dy prej teorizimeve të zakonshme në lidhje me kushtëzimin: qasjet racionaliste dhe qasjet konstruktiviste. Sipas Sedelmeier, teoritë racionaliste e shohin ndikimin e brendshëm të BE-së duke ndjekur një logjikë pasojash, në atë presion adaptiv nga BE ndryshon strukturën e mundësive për aktorët e brendshëm të shërbimeve-maksimizuese. Ajo fuqizon aktorë të caktuar duke ofruar burimet ligjore dhe politike për të ndjekur ndryshimin e brendshëm.⁸ Ndryshe konstruktivistët e shohin vazhdimin e procesit të socializimit, kur faktori vendas përveçetson normat e BE sepse ata i konsiderojnë ato si legjitime. Konstruktivistët, njohin rolin e politikës së brendshme në procesin e anëtarësimit “⁹.

Në fund mund të argumentojnë se, sundimi i ligjit dhe liritë civile që shtetet kanë shumë vështirësi ti zbatojnë dhe zgjerojnë, përmes përdorimit të lidhjeve të caktuara kontraktuale me aktor të jashtëm të demokracisë, të tilla si BE, mund të ndikojnë në efikasitetin e shtetit demokratik. Kapitulli në vijim do të vlerësojë se si kushtëzimi i BE-së ka ndikuar në demokratizimin pas konfliktit të Bosnje-Hercegovinës dhe pastaj të Kosovës.

Rasti studimor: Bosnje dhe Hercegovina

Në vitin 2005, BE-ja hapi zyrtarisht negociatat për anëtarësim për Bosnje dhe Hercegovinën. Përgjatë nëntë viteve vendi arriti të nënshkruajë MSA por për shkak të mosrespektimit të kushteve të BE-së, ajo është ende një kandidat potencial. Ky seksion do të analizojë kushtëzimin e BE-së në drejtim të zbatimit të sundimit të ligjit dhe rritjen e liritë civile në B&H ndërmjet dy periudhave kohore: 2005-2010 dhe 2011-2014. dhe të vlerësojë se si demokratizimi ndikohet përmes kushtëzimit politik.

³ Chandler, “*The European Union and Governance in the Balkans: A Unequal*

⁴ *Partnership*”, f.6 Welzel and Alexander, “*Measuring Effective Democracy*”, f.12

⁵ Schimmelfennig and Sedelmeier, “*Governance by conditionality*”,

⁶ f.675 Tocci, “*The EU and Conflict Resolution*”, f.10 Ibid, f.11

⁷

Sedelmeier, “*Europeanisation in new member and candidate states*”, f.11

Ibid, f.16

Kushtëzimi i BE-së në drejtim të zbatimit të shtetit të së drejtës

Duke filluar me studimin¹⁰, e fizibilitetit, sundimi i ligjit (ndërtimin e mekanizmave institucional për ta trajtuar dhe më pas ta zbatojë atë), është gjetur të jetë një problem për hapjen e procesit të negociatave për anëtarësim. Gjithashtu indeksi i demokracisë e vlerëson aftësinë e sundimit të ligjit në vend mjaft të ulët¹¹. BE e mbështeti fillimin e negociatave nëse, vullneti politik do të krijonte një Ombudsman të vetëm për të tre “popujt përbërës” dhe bashkëpunim të plotë me Gjykatën Ndërkombëtare për Krimet në ish-Jugosllavi¹². Ky kushtëzim është siguruar i dobishëm sepse vendi ishte pothuajse në përputhje me kërkesat e BE-së.

Në vitin 2008 BE-ja dhe B&H ranë dakord mbi një partneritet të ri, Marrëveshjen e Përkohshme, nga të cilat shteti i së drejtës ishte më persistent në lidhje me sistemin gjyqësor dhe politikën anti-korrupsion¹³. Në atë kohë, Komisioni shihte se e vetmja fushë që vendi po arrinte progres substancial ishte sistemi gjyqësor, ky konkludonte se: “një sistem gjyqësor efektiv dhe efikas ka përparuar” dhe “shumë pak progres” është bërë në përmirësimin e mjeteve të saj për të luftuar korrupsionin¹⁴. Por në anën tjetër e vetmja fushë që nuk kishte arritur “asnjë progres” ishte reforma për ndryshimet kushtetuese. Gjithashtu në 2009, janë raportuar dallime të vogla. Lidhur me kuadrin kushtetues, Bosnje Hercegovina kaloi nga “asnjë progres” në “pak progres” dhe në sistemin gjyqësor ndryshoi nga i “avancuar” në ndryshim “të vogël” në 2009¹⁵.

Duke filluar nga viti 2010, Komisioni raportuar progres të kufizuar në procesinë përgjithshme¹⁶. Kjo situatë pati ndikim edhe nga prishja e vullnetit politik në 2008¹⁷, ndërmjet etnive përbërëse, në lidhje me reformimin e kushtetutës. Kjo nënkuptonte një përkeqësim të mëtejshëm të indeksit të perceptimit demokratik të vendit. Në vitin 2010, performanca e B&H në lidhje me sundimin e ligjit ishte më e dobët se në 2005, kur ajo filloi negociatat për anëtarësim. Kjo normë ndryshoi disi qëndrimin e BE ndaj B&H duke ngrirë datën e hyrjes në fuqi të MSA-së¹⁸. Unë argumentojnë se në këtë pikë të procesit, nevoja për reformën kushtetuese ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm, për vazhdimësinë e integritit të vendit dhe formësoi kushtëzimin kryesor që BE shtroi presion ndaj B&H.

Pavarësisht ecurisë, të paktën deri në 2010, vendi kishte përputhshmëri të qëndrueshme me kushtëzimin e BE-së. Ndërkohë BE vazhdoi të mbështesë B&H përmes instrumenteve të vazhdueshme financiare (IPA)¹⁹ dhe për procesin e liberalizimit të vizave i cili nisi në një fazë të mëparshme para liberalizimit të plotë.²⁰ Një tjetër fakt i rëndësishëm të përmendet është se pjesa më e madhe e alokimit financiar gjatë 2008-2010 është dhënë për të mbështetur zbatimin në sundimin e ligjit. Në raportin e Komisionit theksoj se “asistenca është ofruar në fushat e reformës kushtetuese, sundimit të ligjit ...”²¹, edhe pse performanca në gjyqësor ishte e dobët.²² Në këtë qëndrim unë argumentoj se ndonëse në përputhje të ulët me kërkesat e BE-së, “karrotat” që janë ofruar, mund të shihen më shumë si një inkurajim se sa një shpërblim të progresit të arritur.

Deri në 2014, pajtueshmëria e vendit me BE-në ishte e limituar. Sistemi gjyqësor pati “përparim të kufizuar” dhe lufta ndaj korrupsionit e përcakton BiH në një fazë të parakohshme ose “ende në një fazë të hershme në luftën kundër korrupsionit”, sepse “vullneti politik për të trajtuar këtë çështje dhe për të përmirësuar kapacitetet institucionale mbetet e dobët²³”.

Sipas Raportit të Komisionit të 2005 për B&H, Komisioni raportonte se vendi kishte marrë studimin e fizibilitetit në 2003 në të cilin sygjerohej se para-kushtet nuk ishin përmbushur, duke listuar 16 prioritete përpara se negociatat të nisnin, European Commission, BiH, Progress 2005 Report, f.3-5

B&H ishte vlerësuar në vendin e 87 nga 167 shtete në Indeksin e Demokracisë me vlerën (3.29/10.00). The Economist Democracy Index 2007, f.4

Gjithashtu nga progres-raporti i 2005 theksohet se “Nga studimi i fizibilitetit të 2003, arritjet e bëra në pro`esin e shtet-ndërtimit nuk ishin plotësuar. Në lidhje me bashkëpunimin me Gjykatën Ndërkombëtare për Jugosllavinë, raporti e konsideronte Bosnje Hercegovinën se kishte bërë progres të limituar” (European Commission, BiH, Progress Report, 2005, p.8). Gjithashtu BE ofroi incentiva ekonomike për të arritur kërkesat e saj, duke dhënë fonde të IPA dhe asistenca të tjera financiare me shumën prej rreth 200milion euro.(ibid, f.12)

European Commission, BiH, Progress Report 2008, f.4

Ibid, f.14-15

European Commission, BiH, Progress Report, 2009, f.9-14

“Edhe pse pro`esi i ratifikimit ishte arritur prej 25 vendeve antare Marrëveshja e Përkohshme që ishte vendosur si Kushtëzim për formalizimin e MSA nga B&H nuk ishte realizuar. Vendi gjendet në shkelje të plotë me MP për shkak të mospërputhshmërisë me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut” (European Commission, BiH, Progress Report 2010, f.10)

Në kornizën e Marrëveshjes së Prudit të Nëntorit 2008, liderat e tre partive kryesore qeverisëse vendosën që të nisnin negociatat për pro`esin ndaj reformës kushtetuese dhe të prezantonin masa për të harmonizuar Kushtetutën e B&H me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNj) (Ekzistonte një vullnet për të përmbushur kushtet e vendosura nga BE por partitë politike të tri etnive konstituente kishin pikëpamje të ndryshme se si do të organizohej vendi). (European Commission, BiH, Progress Report 2010).

Qëndrimi i Komisionit ndaj progresit të B&H për MSA (European Commission, BiH, Progress Report 2010); Indeksi i Demokracisë e rendiste B&H 9 vende më pak se në 2007 (Indeksi i Demokracisë “The Economist”, 2010, f.5)

Asistenca IPA për 2008 ishte 128.9milion euro; 2009 ishte 98.3 milion euro; dhe në 2010 ishte 74.8milion euro. Të dhëna të cituara nga Komisioni Evropian për Bosnje dhe Hercegovinën gjatë progres raporteve të 2008, 2009 dhe 2010.

Në fillimi të vendit u ofruar lehtësim regjimi vizash(European Commission, BiH, progress report 2008)

European Commission, BiH, Progress Report, 2009, f.12

Duke iu referuar progres raportit të Komisionit Evropian të 2010 “progresi i Bosnje dhe Hercegovinës në fushën e reformës juridike është e limituar në total”. (European Commission, BiH, Progress Report, 2010, f.8)

European Commission, BiH, Progress Report, 2014, f.9

Kushtëzimi i BE-së në drejtim të rritjes së lirive civile

Liritë civile janë një tipar i rëndësishëm i një vendi për të arritur një nivel të rëndësishëm të demokracisë së tij. B&H ka një infrastrukturë institucionale të përshtatshme dhe ka arritur të ratifikojë një numër konventash ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Pavarësisht se, raporti i 2005 gjeti se ende në Republika Srpska, dënimi me vdekje ishte në fuqi për krime kapitale. Kjo nuk ishte në përputhje me standardet e BE dhe u përfshi në objektivat afatshkurtra që Komisioni i kërkoi B&H të përmbushte²⁴.

Duke marrë parasysh indeksin e demokracisë, liritë civile u vlerësuan me tre nga shtatë pikë, duke treguar se vendi ishte në vështirësi për ti forcuar ato.²⁵ Megjithatë kushtëzimi i BE-së ishte më e përqendruar në zbatimin e sundimit të ligjit dhe liritë civile si një sferë e ndërlidhur për demokratizimin nisi të jetë një shqetësim pas viti 2007. Rasti Dsizich dhe Filinc (2007) tregoi nevojën për të reformuar kushtetutën, në mënyrë që vendi të jetë plotësisht në përputhje të plotë me Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut²⁶. Progres raporti i 2008 theksonte se: “Megjithëse konventat ndërkombëtare janë aplikuar drejtpërdrejtë, implementimi i tyre kërkon të përmirësohet. Sa i përket promovimit dhe të lirive civile ai mbetet i pakënaqshëm”²⁷. Këto ishin sinjale se BE -ja ishte duke i dhënë prioritet të lartë mbi ata dhe të cilat do të ndikojnë në kushtet e reja që Komisioni është duke përgatitur drejt finalizimit të procesit të MSA-së.

Kështu, progres raporti i 2010 theksonte me “zë të lartë” ndaj mbrojtjes për të drejtat civile duke deklaruar se vendi “nuk ka bërë asnjë përparim të mëtejshëm”.²⁸. Të gjitha fushat që ky raport përmend pothuajse nuk janë plotësuar krahasuar me vitet e mëparshme kur nivel pajtueshmërie ishte arritur. Gjithashtu, dështimin i iniciativës SHBA-BE për reformën kushtetuese përmes Marrëveshjes së Prudit dhe vendimit të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, e cila gjeti një shkelje mbi të drejtën që gjenden etnisë me bazë në të drejtën për t’u zgjedhur papajtueshme me parimet e përgjithshme të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, që B&H ishte pjesë e saj ligjor që. Pa zgjidhjen e kësaj papajtueshmërie procesi do të ngelej i bllokuar. Çfarë kishte ndryshe progres raporti i 2014 ishte fakti se Komisioni suportoi protestat e “pranverës” në BiH duke e parë me vëmendje shqetësimin civil në lidhje me situatën socio-ekonomike në vend. Kjo qasje e re që Komisioni përmend për të përdorur në këtë drejtim, shpreh një mbështetje të drejtpërdrejtë që i ofrohet qytetarëve duke nisur tre iniciativa për të zhvendosur fokusin drejt reformave dhe çështje që ka shqetësim të drejtpërdrejtë për to “.²⁹ Ky vlerësim i ri do të ketë implikime të mëtejshme në vitet në vijim se si BE-ja do të ndjekë strategji të reja për të mbështetur kushtëzimin e saj në drejtim të aktorëve të tjerë me influencë të shoqërisë.

Rasti studimor: Kosova

Në 2013, BE-ja hapi zyrtarisht negociatat e anëtarësimit për Kosovën. Aktualisht Kosova e ka sigluar MSA dhe përgjatë 2015 pritet ta çoi procesin përpara. Në këtë pjesë do të analizojë kushtëzimin e BE-së të bazuar në dy inkuadrim periodike: 2008-2012 dhe 2013-2014

Kushtëzimi i BE-së ndaj zbatimit të shtetit të së drejtës

Kosova është shteti më i ri në rajon që synon për të nënshkruar MSA-në. Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, BE-ja është më e përfshirë (Misioni i EULEX-it). Progres - raporti i 2008 nuk ishte i pari që Komisioni kishte përgatitur për Kosovën, por ajo ishte menduar si një studim para-fizibilitetit për të vlerësuar infrastrukturën e përgjithshme institucionale që vendi i ri kishte krijuar. Në 2009, Kosova po ndiqte një linjë reformash mjaft të favorshme në drejtim të qëllimeve të saj integruese, ndaj the progresi raporti i atij viti theksonte se vendi duhet të bëjë përparim të mëtejshëm në themelimin dhe konsolidimin e shtetit ligjor dhe ka nevojë për të përmirësuar funksionimin dhe pavarësinë e gjyqësorit”³⁰. Kushtëzimi i BE-së është bazuar në kërkesat e ndërtimit të institucioneve (të Gjykatës Kushtetuese) dhe agjencive publike në monitorimin e luftës kundër korrupsionit dhe formave të tjera të krimit të organizuar duke i ofruar vendin, si një shpërblim fillimin e dialogut për liberalizimin e vizave.

Progres-Raportet e 2010 dhe 2011, treguan në përgjithësi se ky progres ishte arritur. Sa i përket sektorit të gjyqësorit, Komisioni u shpreh se “Kosova ka bërë progres në këtë fushë³¹ dhe në politikën anti-korrupsion të vendit “është arritur

European Commission, BiH, Progress Report, 2005, f.20

The Economist Democracy Index 2007, f.4

Rasti në fjalë u bë serioz pasi lidhej drejt për së drejti me liritë civile, pas mohimit që i u bë qytetarit Rom dhe atij Hebre për të marrë pjesë në garën për kandidat presidencial nga Komitetit Qendror i Zgjedhjeve. I menjehershëm qe reagimi i BE, pasi e shihte atë si shkelje e hapur e Protokollit 12 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut ku B&H ishte shtet nënshkruar dhe ndaj heshtja u dërgua për gjykim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

European Commission, BiH, Progress Report, 2008, f. 23

European Commission, BiH, Progress Report, 2010, f.12

European Commission, BiH, Progress Report, 2014, f.17

European Commission, Kosovo, Communication, 2009, f.3

European Commission, Kosovo, Progress Report, 2010, f.10

progres”.³² Mund të themi se këto arritje kanë qenë të besueshme pasi renditja e Kosovës në indeksin e demokracisë, vlerësuar më pozitivisht nga vitet e kaluara.³³

Kështu vendi ishte i gatshëm për të vlerësuar nga raporti i studimit të fizibilitetit si mekanizmi paraprak për fillimin e negociatave zyrtare të anëtarësimit. Komisioni raportonte se “gjatë tre viteve të fundit, funksionimi i institucioneve demokratike dhe respektimi për sundimin e ligjit janë konsoliduar. Institucionet e nevojshme janë krijuar”³⁴. Kjo deklaratë është parë si një përpjekje për vendin që të ketë një hapje zyrtare dhe gjithashtu vlerëson arritjet në përgjithësi që janë arritur nëpërmjet politikës së kushtëzimit të BE-së që nga viti 2008.

Me këto kushte dhe kërkesa BE nuk harroi të ofronte shpërblimin dhe vazhdo inkurajimin. Në rastin e Kosovës ato kanë qenë vetëm në ndihmë financiare. Financimet nga IPA arritën gati 400mln euro³⁵ Liberalizimi i vizave u mendua si një perspektivë afat mesme dhe afatgjatë edhe pse procesi i lehtësimi të vizave është arritur. Kjo mund të shpjegohet si një aspekt tjetër afrohet mëparshëm me nxitim shpërblimit në rast se e kam analizuar në BiH. Sotëm Kosova është ende në pritje për liberalizimin e vizave.

Në dy progres-raportet e fundit, 2013 dhe 2014 Komisioni vlerësonte në përgjithësi zbatimin për sundimin e ligjit pozitivisht por me një shqetësim të dukshme”³⁶. Kjo logjikë që BE-ja është duke e aplikuar në Kosovë ka disa ngjashmëri me qasjen e KB (UNMIK 2004) “Standardet para statusit”³⁷, që nënkupton angazhim së pari nga institucionet e vendit për demokratizimin dhe më pas BE do të shpërblejë. Me këtë supozim unë do të analizojnë rritjen e lirisë civile në Kosovë përmes kushtëzimit të BE-së.

Kushtëzimi i BE ndaj lirisë civile

Për sa i përket lirisë civile progres-raporti i 2008 e gjeti situatën e përgjithshme në, institucionet, ligjet dhe qasja qeverisë të qëndrueshme. Ndryshe, raporti i 2009 vinte theksin se Kosova kishte një nevojë për të përmirësuar mbrojtjen e serbëve dhe pakicave të tjera dhe të rriste dialogun dhe pajtimin midis komuniteteve etnike. Në përgjithësi kohezioni kërkon të forcohet”³⁸. Këto kërkesa janë nënkuptuar edhe në qasjen e zgjeruar të BE-së për dialogun Prishtinë-Beograd në vitin 2012.

Megjithatë statusi ndërkombëtar i ndërlikuar i Kosovës, krijon vështirësi për vendin ndaj zbatimit të instrumenteve ndërkombëtare e të drejtave të njeriut për shkak se ajo nuk është subjekt i asnjë prej konventave të organizatave ndërkombëtare për raportim të rregullt dhe bashkëpunimi në fushën e të drejtave të njeriut, që është arsyeja pse raporti i 2010 rekomandoi që të ketë më shumë dialog me institucionet përfaqësuese të BE-së.³⁹ Në progres-raportet e 2011 dhe 2012 raportet e progresit, Komisioni e “ftonte Kosovën që të intensifikojë reformat në fushën e lirisë civile dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të përqendrohet në zbatimin e tyre”⁴⁰. Për Komisionin: “Ritmi i përparimit varet vetëm nga Kosova”⁴¹. Unë argumentoj se kjo gjuhë e përdorur nga BE-ja është një përpjekje për arritjen e dialogut Prishtinë-Beograd. Ky perceptim do të hulumtohen në 2013 si kushtëzimit politik që BE-ja kërkon t’ia imponoj ndaj të dy vendeve: fillimi i negociatave për MSA-në (Kosovë) dhe hyrjen në fuqi të MSA-së (Serbi).

Ndryshimi i gjuhës në 2013 paraqitet i qartë: “Pas përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur në shtator të vitit 2012, kadri ligjor i Kosovës vazhdon të garantojë përfaqësimin të pakicave”⁴² Në të njëjtën mënyrë vazhdohet në raportin e 2014: “Në përgjithësi, Kosova ka bërë progres në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe rritjen e lirisë civile”⁴³. Kjo duket më qartë kur theksohet se “përparimi i Kosovës drejt të ardhmes së saj evropiane ka qenë e mundur për shkak të përparimit të bërë nga Kosova në reforma dhe angazhimin e saj të vazhdueshëm për normalizimin e marrëdhënies së saj me Serbinë”⁴⁴. Edhe pse logjika do të ishte në të njëjtën mënyrë si në lidhje me zbatimin e sundimit të ligjit, unë argumentoj se në këtë vit, Kosova ka të drejtë të presë marrjen e një sasive të konsiderueshme “karrotash” aq shumë të nevojshme për vendin dhe shoqërinë në përgjithësi.

Analiza krahasuese

Pas analizimit të secilit rast studimor mbi kushtëzimin e BE-së në drejtim të zbatimit të sundimit të ligjit dhe rritjen e lirisë civile, si parakushte të demokratizimit, unë argumentoj se në rastin e B&H, BE filloi ta përdorte kushtëzimin që prej studimit

European Commission, Kosovo, Progress Report, 2011, f.13

Economist Democracy Index 2010, f.5

European Commission, Kosovo, Communication, 2012, f.5

Ndërmjet viteve 2008 dhe 2012, fondet IPA mundësuan një shumë të përgjithshme prej 400 milion euro. Të dhënat u mbledhën nga progres raportet e Komisionit Evropian për Kosovën gjatë viteve 2008, 2009, 2010, 2011 dhe 2012.

European Commission, Kosovo, Progress Report, 2013, f.8

“Standards for Kosovo” A Security Council Report, 2003

European Commission, Kosovo, Communication, 2009, f.9

European Commission, Kosovo, Progress Report, 2010, f.19

European Commission, Kosovo, Progress Report, 2011, f.16

European Commission, Kosovo, Communication, 2012, f.7

European Commission, Kosovo, Progress Report, 2013, f.7

European Commission, Kosovo, Progress Report, 2014, f.12

Ibid, f.15

të fizibilitetit në 2003. Vendi arritur një përparim të dukshëm deri në 2008 kur Komisioni raportonte kryesisht “përparim” ndaj sundimin e ligjit dhe lirive civile. Kjo është vlerësuar edhe në treguesit e indekseve të demokracisë ndaj fushave që lidhen me sundimin e ligjit dhe të lirive civile duke shënuar një ndryshim pozitiv ndaj viteve të mëparshme. Kështu “shpërblimet/ karrotat” e BE ishin kryesisht mbi asistencën financiar (IPA). Ndryshe, rasti i Kosovës tregoi se kushtëzimi i BE-së filloi të përdoret që nga shpallja e pavarësisë me raportin mbi para studimin e fizibilitetit të 2009. BE e “shpërbleu” vendin me financime të IPA në qoftë se do të kishte përputhshmëri me kërkesat e Komisionit. Arritjet nisën të jenë të rëndësishme kryesisht në sundimin e ligjit, kur Komisioni deklaronte kryesisht “përparim” deri në 2012, por mbi të drejtat civile vlerësim ishte kritik sepse BE-ja po e shtyn vendin për të arritur dialogun me Beogradin.

Ndërkaq në 2010 B&H u gjend në një situatë të vështirë për shkak të mosrespektimeve të mëdha me kërkesat e BE dhe hyrja në fuqi e MSA-së u bllokua. Edhe pse BE-ja e diferencuar të dobishme e saj duke aplikuar inkurajim për procesin, lëshimin programin e liberalizimit të vizave në dhjetor të të njëjtit vit. Kjo qasje nuk solli rezultatet e pritura në vitet që pasuan. Në rastin e Kosovës, edhe pse vendi arriti disa përparime me kërkesat e BE, ndaj unionin priste më shumë që të bëhej nga vullneti politik dhe më pas të jepte shpërblimin me hapjen e procesit të negociatave aderimit. Në fakt kjo u arrit vetëm në 2013 dhe ndryshe nga B&H. Gjithashtu BE-ja ndryshoi qëndrimet e saj ndaj B&H për shkak të mosrespektimit të kushteve të vendosur nga unioni duke bllokua fondet IPA dhe duke paralajmëruar për ngrirjen edhe të liberalizimin e vizave⁴⁵. Progres-raportet e Komisioni e zhvendosën vlerësimin nga “progres të kufizuar në shumë pak” midis 2010 dhe 2014. Në rastin e Kosovës, Komisioni raportoi “disa të progresit të kufizuar” dhe BE-ja është në pritje të arriturat e progresit të caktuar për të ofruar sasinë e stimujve si e dobishme.

Mund të argumentojmë se në rastin e B&H kushtëzimi përdori një nivel të caktuar ndikimi ndaj zbatimit të sundimit të ligjit dhe lirive civile gjatë fazës së parë (2005-2008) dhe ka pasur një ekuilibër ndërmjet kërkesave dhe stimuj. Por gjatë 2008-2010, kur perceptimi i indeksit të demokracisë ishte duke u zhvlerësuar, BE sërish e inkurajoi B&H me një nivel të konsiderueshëm stimujsh siç ishte liberalizimi i vizave, ndonëse vendi vazhdoi të dështonte për të arritur kërkesat e BE-së. Ndonëse BE-ja përdori më shumë presionin me politikën e kushtëzimit duke ngrirë stimujt financiarë dhe paralajmërim për ngrirjen liberalizimin e vizave vendi sërish nuk e ka arritur pajtueshmërinë e reformave që kërkohen nga BE.

Ndryshe në rastin e Kosovës, mund të argumentojmë se BE ndryshoi qëndrimin e saj ndaj kushtëzimit. Ajo përdori qasjen “të mësojmë duke punuar”: duke ofruar shpërblim vetëm kur vendi arriti një shkallë të caktuar pajtueshmërie duke ofruar stimuj të ndryshëm. Kjo qasje mund të ketë disa karakteristika me “standardet para statusit”, e përdorur nga OKB-ja në vitin 2003. Në përgjithësi politika e kushtëzimit të BE-së u shfaq të ishte më e suksesshme sipas parimit “shkopinj karrota” për rastin e Kosovës se sa në rastin e B&H në drejtim të arritjes së një shkallë më të balancuar të demokratizimit.

Konkluzione

Ky punim kishte për qëllim të analizojë se si procesi i zgjerimit të BE-së, përmes kushtëzimit ka ndikuar në demokratizimin në vendet post-konflikteve të Ballkanit Perëndimor, në një studim krahasues të B&H dhe Kosovës. Qëndrimi im ndaj këtij studimi mbështetet në supozimin se edhe pse Bashkimi Evropian ushtron presion shtrëngues nëpërmjet politikës së kushtëzimit në lidhje me zbatimin e sundimit të ligjit dhe rritjen e lirive civile, demokratizimi në vendet post-konfliktuoze të Evropës Juglindore, vazhdon të mbetet në ngërç.

Pasi u krahasuan dy rastet të marra në studim mund të argumentoj se supozimi i mësipërm i cili u prezantua në fillim të punimit ka nevojë të riformulohet nga rezultatet e arritura gjatë analizimit të secilit rast studimor. Për mbështetur argumentin u përdorën të dhëna parësore nga progres raportet vjetore të Komisionit Evropian përgjatë viteve të përcaktuara duke analizuar më specifikisht sundimi i ligjit dhe liritë civile nëse institucionet shtetërore kishin arritur ti forconin ose ende vazhdonin të mbështetshin të dobëta për të vlerësuar më tej demokratizimin e secilit vend.

Nëpërmjet analizës krahasues evidentohet se në rastin e B&H kushtëzimi u përdor për të ndikuar në një farë mase forcimin e zbatimit të shtetit ligjor dhe rritjen e lirive civile në fazën e parë (2005-2008) duke pasur një ekuilibër ndërmjet kërkesave dhe stimujve të ofruar. Por gjatë 2008-2010, kur perceptimi i indeksit të demokracisë ishte duke u zhvlerësuar, BE sërish e inkurajoi B&H me një nivel të konsiderueshëm stimujsh siç ishte liberalizimi i vizave, ndonëse vendi vazhdoi të dështonte për të arritur kërkesat e BE-së. Ndonëse BE-ja përdori më shumë presionin me politikën e kushtëzimit duke ngrirë stimujt financiarë dhe paralajmërim për ngrirjen liberalizimin e vizave vendi sërish nuk e ka arritur pajtueshmërinë e reformave që kërkohen nga BE.

Ndryshe në rastin e Kosovës, mund të argumentojmë se BE ndryshoi qëndrimin e saj ndaj kushtëzimit. Ajo përdori qasjen “të mësojmë duke punuar”: duke ofruar shpërblim vetëm kur vendi arriti një shkallë të caktuar pajtueshmërie duke ofruar stimuj të ndryshëm. Kjo qasje mund të ketë disa karakteristika me “standardet para statusit”, e përdorur nga OKB-ja në vitin 2003. Në përgjithësi politika e kushtëzimit të BE-së u shfaq të ishte më e suksesshme sipas parimit “shkopinj karrota” për rastin e Kosovës se sa në rastin e B&H në drejtim të arritjes së një shkallë më të balancuar të demokratizimit.

Në përfundim mund të themi se politika e kushtëzimit të BE-së e përdorur në rastin e Kosovës ishte më e qëndrueshme dhe më e besueshme sesa në rastin e B&H në drejtim të arritjes së një niveli më të balancuar të demokratizimit. Ky argumentim është në mbështetje me supozimin fillestar i cili shërbeu si vektori për analizën e këtij punimi, ndaj tashmë pas paraqitjes së rezultateve nga punimi do të na duhet ta riformulojmë në këtë mënyrë: Bashkimi Evropian forcon presionin e saj shtrëngues

pasi vlerëson papajtueshmërinë e vendit (B&H) me politikën e Kushtëzimit. Ndaj dhe demokratizimi ngelet në ngërç. Por ajo “mëson duke punuar”, kur është fjala për Kosovën, duke përdorur një presion të ekuilibruar detyrues dhe pasi merr pajtueshmërinë e mjaftueshme me Kushtëzimin ofron një masë të caktuar shpërblimi dhe po ashtu stimulsh.

Bibliografia

- European Commission (2005) Bosnia and Herzegovina Progress Report in “Enlargement Strategy and Main Challenges” 2005-2006 p.1-76
- European Commission (2008) Bosnia and Herzegovina Progress Report” in “Enlargement Strategy and Main Challenges” 2008-2009 p.1-64
- European Commission (2009) Bosnia and Herzegovina Progress Report” in “Enlargement Strategy and Main Challenges” 2009-2010 p.1-67
- European Commission (2010) Bosnia and Herzegovina Progress Report” in “Enlargement Strategy and Main Challenges” 2010-2011 p.1-65
- European Commission (2012) Bosnia and Herzegovina Progress Report” in “Enlargement Strategy and Main Challenges” 2012-2013 p.1-60
- European Commission (2014) Bosnia and Herzegovina Progress Report” in “Enlargement Strategy and Main Challenges” 2014-2015 p.1-68
- European Commission (2008) Kosovo (UNDER UNSCR 1244/99) Progress Report” in “Enlargement Strategy and Main Challenges” 2008-2009 p.1-59
- European Commission (2009) COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT AND THE COUNCIL Kosovo (UNDER UNSCR 1244/99) Fulfilling its European Perspective p.1-15
- European Commission (2010) Kosovo (UNDER UNSCR 1244/99) Progress Report” in “Enlargement Strategy and Main Challenges” 2010-2011 p.1-61
- European Commission (2011) Kosovo (UNDER UNSCR 1244/99) Progress Report” in “Enlargement Strategy and Main Challenges” 2011-2012 p.1-64
- European Commission (2012) COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT AND THE COUNCIL on a Feasibility Study for a Stabilisation and Association Agreement between the European Union and Kosovo (UNDER UNSCR 1244/99) p.1-14
- European Commission (2013) Kosovo (UNDER UNSCR 1244/99) Progress Report” in “Enlargement Strategy and Main Challenges” 2013-2014 p.1-56
- European Commission (2014) Kosovo (UNDER UNSCR 1244/99) Progress Report” in “Enlargement Strategy and Main Challenges” 2014-2015 p.1-64
- Tocci, N. The EU and Conflict Resolution: Promoting Peace in the Backyard, London: Roudge, 2007
- Literatura nga interneti**
- Chandler D. 2003 “The European Union and Governance in the Balkans: A Unequal Partnership in European Balkan Observer vol. 1 No.2 Published by the Belgrade Centre for European Integration and The Vienna Institute for International Economic Studies pp.1-26 Për më shumë: <http://www.davidchandler.org/wp-content/uploads/2014/10/EBO.pdf> (Aksesuar më 20.01.2015)
- Sedelmeier, U. 2011 “Europeanisation in new member and candidate states” in Living Reviews in European Governance, Vol. 6, (2011), No.1 pp. 1-52 Për më shumë: <http://europeangovernance.livingreviews.org/Articles/lreg-2011-1/download/lreg-2011-1Color.pdf> (Aksesuar me 28.01.2015)
- Schimmelfennig, F. and Sedelmeier, U. 2004 “Governance by conditionality: EU rule transfer to the candidate countries of Central and Eastern Europe” in Journal of European Public Policy 11:4 August 2004: 669–687 Për më shumë: http://www.mzes.unimannheim.de/projekte/typo3/site/fileadmin/research%20groups/1/teamB-reader/Schimmelfennig%20%26%20Sedelmeier_Governance%20by%20conditionality.pdf (Aksesuar me 25.01.2015)
- The Economist Democracy Index 2007 “The World in 2007: The Economist Intelligence Unit’s index of democracy” ed. Laza Kekic. Për më shumë: http://www.economist.com/media/pdf/DEMOCRACY_INDEX_2007_v3.pdf (Aksesuar,e 30.01.2015)
- The Economist Democracy Index 2010 “The World in 2010: The Economist Intelligence Unit’s index of democracy” ed. Laza Kekic. Për më shumë: https://graphics.eiu.com/PDF/Democracy_Index_2010_web.pdf (Aksesuar me 27.01.2015)
- UN Security Council Report: “Standards for Kosovo”, presented in Prishtina 10 December 2003 Për më shumë: <http://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kos%20Standards.pdf> (Aksesuar me 26.01.2015)
- Wexel, Ch. and Aleksanderin, A.C. “Measuring Effective Democracy: The Human Empowerment Approach” in World Value Reseach vol.1 No.1 2008, pp.1-34 Për më shumë: http://www.hse.ru/pubs/lib/data/access/ram/ticket/38/142220069500edf492794616562e482e595b75f084/WVR_01_01_Welzel_and_Alexander.pdf (Aksesuar me 19.01.2015)

VLERËSIMI I AMBJENTIT TË SIGURISË NË VENDET E RAJONIT

DOKT. VILMA SPAHIU

Asistente Pedagoge në Universitetin Europian të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale & Edukimit, E-mail:vspahiu@uet.edu.al

PROF. DR. PËRPARIM FUGA

Prorektor në Universitetin Europian të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale & Edukimit, E-mail:perparim.fuga@uet.edu.al

ABSTRAKT

Prezenca e formave të ndryshme të veprimtarive të grupeve kriminale dhe infiltrimi i tyre në sfera të ndryshme, si në atë shoqërore, ekonomike dhe politike po kthehet gjithnjë e më shumë në një faktor thelbësor destabilizues dhe frenues për konsolidimin dhe zhvillimin e shoqërive të vendeve të rajonit tonë. Fakt ky i cili i rrit rëndësinë e vlerësimit të ambientit të sigurisë për vendet e rajonit. Qëllimi i këtij punimi është analizimi i operimit të Krimin të Organizuar në vendet e rajonit si dhe identifikimi i operimit të këtyre veprimtarive kriminale përtej kufirit të shtetit të tyre. Vendet e marra në shqyrtim do të jenë Kroacia, Serbia, Turqia dhe Shqipëria. Nëpërmjet këtij punimi, do të përpiqemi që të identifikojmë faktorët/elementët që kanë favorizuar funksionimin e këtyre veprimtarive, format nëpërmjet të cilave qeveritë e këtyre shteteve kanë bërë përpjekjet për të kufizuar operimin e tyre dhe niveli i efikasitetit të politikave të ndërmarra prej tyre, si dhe sfidat e së ardhmes. Të dhënat e përdorura për këtë punim bazohen në shfrytëzimin e literaturës, në të dhënat zyrtare të qeverive të shteteve të marra në analizë si dhe raportet ndërkombëtare mbi pozicionimin e tyre në luftën kundër Krimin të Organizuar.

Fjalë kyç: *Siguri; krim i organizuar; vendet e rajonit.*

Hyrje

Krimi i organizuar është një dukuri e cila për disa vende të botës është relativisht e re, ndërsa për disa vende të tjera ajo është e vjetër. Historia ka treguar se shumë liderë politikë ndërkombëtar, janë mbështetur tek krimi i organizuar, pra në strukturat dhe në metodat kriminale për të udhëhequr. Një pjesë e tyre, kanë ardhur pikërisht në pushtet nëpërmjet përdorimit të këtyre veprimtarive kriminale. Ndër to mund të përmendim Adolf Hitler, Jozef Stalin, Mao Ce Dun, Pinoceti, Nikola Caushesku, Slllobodan Milosheviç etj. Është vënë re, se këto figura të mëdha politike dhe historike nuk i kanë përdorur veprimtaritë kriminale, pra krimin e organizuar vetëm për të ardhur në pushtet, por ata i kanë përdorur edhe pas ardhjes së tyre, pra për ta mbajtur pushtetin. Krimi i organizuar ka evoluar, në ditët e sotme, veprimtaritë kriminale kanë njohur zhvillime të mëdha në mënyrën e organizimit, kjo shihet qartë në trafikun me përmasa tepër të mëdha të llojeve të ndryshme të drogave, në përdorimin gjithnjë e në rritje të dhunës, duke përfshirë në këtë mënyrë pothuajse të gjithë vendet e botës. Krimi i organizuar në ditët e sotme po ndikon në pasigurinë kombëtare të shteteve. Forcimi i veprimtarive kriminale, po kthehet në një problem apo në një kërcënim serioz për sistemin ndërkombëtar, sepse shumë shtete janë të përfshira ose në prodhimin e kanabisit, ose në vende të cilat njihen gjerësisht për pastrimin e parave, ose në vende të cilat shërbejnë si vende tranziti për shpërndarjen e heroinës. Krimi i organizuar ka evoluar në kohë dhe është përpjekur vazhdimisht të ndërtojë baza dhe struktura të fuqishme duke rivalizuar në këtë mënyrë fuqinë e shteteve si dhe duke nxjerrë në pah dobësinë e shteteve si dhe institucioneve të tij.

Punimi adreson dy çështje të rëndësishme, e para lidhet me identifikimin e elementëve/faktorëve të cilët kanë favorizuar funksionimin e veprimtarive kriminale në vendet e rajonit dhe e dyta lidhet me analizimin e nivelit të efikasitetit të politikave qeveritare të tyre në kufizimin e operimit të këtyre veprimtarive. Një çështje e rëndësishme e këtij punimi do të jetë edhe sfidat e së ardhmes për vendet e marra në shqyrtim, përkatësisht Kroacia, Serbia, Turqia dhe Shqipëria.

Instrumentet e kërkimit të përdorura në këtë punim do të jenë: shfrytëzimi i literaturës, të dhënat zyrtare të qeverive të vendeve të marra në analizë, si dhe raportet ndërkombëtare.

Krimi i organizuar në Europë

Kontinenti European ndër vite ka njohur rritje të krimit të organizuar. Mirëpo, shumë vende të Europës janë përballur me rritjen e krimit të organizuar veçanërisht pas viteve 90-të. Veprimtaritë kriminale, pra krimi i organizuar në këto vende është shfaqur në forma të ndryshme. Grupet kriminale ndryshojnë nga njëri tjetri si pasojë e strukturave të tyre, ato mund të përbëhen nga një strukturë tepër e fortë hierarkike, pra një ndarje rolesh dhe pjesëtarët e këtij grupi kriminal kanë lidhje gjaku midis tyre. Por, mund të ndodhë që një organizim kriminal të ketë një strukturë horizontale dhe kryesisht anëtarët e këtij grupi të kenë një lidhje shoqërore, miqësore apo edhe një lidhje punë midis tyre. Pra, si rezultat i këtyre strukturave të ndryshme, krimi i organizuar në Europë nuk ka qenë i njëjtë për të gjitha vendet e tij.

Për një kohë shumë të gjatë, krimi i organizuar në Europën Perëndimore është përfaqësuar nga mafia italiane si dhe nga grupet kriminale të vendeve si Franca apo Gjermania. Studimet e shumta në ditët e sotme tregojnë se krimi i organizuar ka ndryshuar tendencat në dy drejtime kryesore: në atë të subjekteve të përfshira në të dhe të veprimtarisë së tij (Hysi, 2005: 166). Kjo nënkupton se, grupet kriminale po përpriqen gjithnjë e më shumë që të përfshijnë në grupet e tyre, personat me një influencë të madhe në tregjet botërore, si dhe personat profesionistë në fushat e tyre. Përveç kësaj strategjie, grupet e ndryshme kriminale që operojnë në Europë po përpriqen që të ndryshojnë strukturat dhe format e tyre të bashkëpunimit. Ato po përpriqen që ti shmangen strukturës së tyre hierarkike dhe të centralizuar dhe po përqendrohen në forcimin e aleancave dhe bashkëpunimeve midis grupeve të ndryshme.

Pas viteve 90-të, vendet e shumta ish- komuniste u përballen me kriminalitetin në një shkallë tepër të lartë. Këto vende u përballen me grupe kriminale, të cilat kryenin aktivitete të tilla si, trafiku i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore për shfrytëzim seksual, emigrimi ilegal, trafikimi i armëve etj. Këto krime kanë depërtuar, pra janë përhapur gjerësisht në vendet në tranzicion, të cilat përbëjnë furnizuesit kryesor për vendet e Europës Perëndimore.

Një formë tjetër e rëndësishme e krimit të organizuar në Europë është edhe krimi kompjuterik. Interneti po përdoret si një mjet për realizimin e veprimtarive të tilla si trafiku i drogave të ndryshme apo edhe kërcënim. Ndër format më të përhapura të krimit kompjuterik, mund të jenë, "futja në sistemet kompjuterike pa autorizim, vjedhje e të hollave në llogaritë bankare kur personat kryejnë veprime me bankën nëpërmjet internetit, prodhime ilegale të disqeve të software-ve etj" (Wall, 2002: 3). Gjithashtu, vende të tilla të Europës Perëndimore si, Malta, Luksemburgu, Litenshtejni dhe Zvicra (konsiderohet edhe si një nyje e rëndësishme e trafikut të drogave drejt vendeve të tjera të Europës) janë përballur edhe me fenomenin e pastrimit të parave. Këto vende për grupet kriminale, janë shumë tërheqëse për pastrimin e parave, të cilat burojnë nga aktivitetet ilegale.

Karakteristikat e krimit të organizuar në Kroaci/ Serbi/ Turqi/ Shqipëri

Pavarësisht shkaqeve të fillimit dhe të vazhimit, "lufta në vetvete përbën një çorganizim social, i cili ndikon në rritjen e strukturës së kriminalitetit" (Hysi, 2005: 219). Gjithashtu, luftërat ndikojnë edhe në ekonominë e vendit. Sepse, shtetet në luftë, ndryshojnë orientimin e ekonomisë, duke e fokusuar atë drejt industrisë ushtarake dhe asaj të mbrojtjes. Në kohë lufte, shumica e krimeve kryhet për shkak të rrethanave, të cilat krijohen aty për aty. Megjithatë, krahas këtyre krimeve, gjatë

periudhës së zhvillimit të luftës, krijohen kushtet e favorshme për forma të tjera të krimit si, rrëmbimet e personave, abuzimet seksuale, krime kundër njerëzimit etj.

Kaosi i shkaktuar nga lufta, sjell mosfunksionimin e plotë të shtetit dhe të institucioneve të tij, duke i hapur rrugë në këtë mënyrë operimit të veprimtarive të organizuara kriminale. Grupet e ndryshme kriminale, shfrytëzojnë këtë gjendje kaosi, të shkaktuar nga lufta, për të shtrirë rrënjët e tyre, pra për të krijuar bazat e tyre aty. Por, ata e shfrytëzojnë këtë gjendje kaosi edhe për të arritur përfitime sa më të mëdha, pra për t'u fuqizuar. Gjithashtu vihet re se grupet kriminale edhe pas periudhës së anarkisë, pra pas përfundimit të luftës, shfrytëzojnë mosfunksionimin e institucioneve për rritjen e veprimtarisë së tyre.

Shfaqja e krimit të organizuar në Kroaci vërehet me shkëputjen e saj nga ish-Jugosllavia dhe në embargon e armëve duke detyruar në këtë mënyrë qeverinë kroate të drejtohet tregut të zi për të siguruar mbrojtjen e tyre. Periudha më e artë e operimit të grupeve kriminale kroate konsiderohet periudha e luftës. Të etiketuar/promovuar si heronj të luftës shumica e këtyre grupimeve e vazhduan veprimtarinë e tyre kriminale edhe pas saj. Kaosi i krijuar si pasojë e shkëputjes, u pasua me mungesën e mbikëqyrjes mbi shpenzimet e parave nga buxheti i shtetit, çka u mundësoi rrethana të favorshme individëve për të përfituar në aspektin financiar dhe në atë politik. Vlen të theksohet fakti që në Republikën e Kroacisë, grupet kriminale nuk operojnë sipas formës klasike, sepse nuk ekzistojnë marrëdhëniet hierarkike ndërmjet anëtarëve të grupit. Krimi i organizuar në Republikën e Kroacisë pas viteve 90-të u përcaktua nga tre elementë të rëndësishëm: - pozicioni gjeografik; - proceset gjithëpërfshirëse ndërkombëtare; - pasojat e shpërbërjes së Jugosllavisë. Fushat në të cilën operoi/operon krimi i organizuar ishin: "kontrabanda me narkotikë, pastrimi i parave, armët, trafikimi i qenieve njerëzore, korrupsioni, kërcënimet, vrasjet" (Stojarova, 2007: 93).

Ndërsa për sa i përket shfaqjes dhe forcimit të krimit të organizuar në Serbi, faktorët që ndikuan ishin, kaosi i luftës dhe anemia e plotë shoqërore, e cila u theksua më shumë me futjen e sanksioneve ekonomike të OKB-së. Kjo ndikoi shumë në krijimin e një klime shoqërore dhe psikologjike, ku çdokush i cili arrinte të thyente bllokadën e OKB-së, perceptohej si një person i cili kishte arritur rezultate pozitive dhe jo si një person i cili kishte kryer veprimtari të jashtëligjshme. Në këto rrethana të krijuara shteti jo vetëm i toleronte operimin e këtyre veprimtarive kriminale, por ishte në disa raste vetë shteti i cili i nxiste këto veprimtari. Duhet theksuar fakti që, krimi i organizuar serb ka jetuar në simbiozë me shtetin dhe te dy këto aktorë kanë përfituar nga njëri-tjetri. Gjithashtu, mund të themi që niveli më i lartë i kriminalitetit të shfaqur në Serbi ka ardhur si rezultat i konfliktit Kroato-Boshnjak, ku këto grupe kriminale kanë luftuar për llogari të grupeve paramilitare të mbështetura nga qeveria serbe. Mënyra e strukturimit të këtyre grupeve kriminale është horizontale. Kjo nënkupton mungesë të një hierarkie të fortë midis grupeve si dhe një shkallë e lartë pavarësie në lidhje me aktivitetet e tyre, sepse anëtarët e nivelit të mesëm nuk koordinohen nga një udhëheqës. Fushat në të cilën operon krimi i organizuar në Serbi janë: kontrabanda narkotike, trafikimi i personave, pastrimi i parave, vjedhjet, shpërdorimi i burimeve publike dhe privatizimeve, prodhimi i paligjshëm i software etj. (Stojarova, 2007: 100).

Pozicioni strategjik e bën Turqinë një vend shumë të rëndësishëm tranziti për emigracionin e paligjshëm në drejtim të vendeve të Bashkimit Europian duke krijuar kështu kushte të favorshme për operimin e veprimtarive kriminale. Vihet re që me përfundimin e Luftës së Ftohtë, grupet kriminale turke u përfshinë në trafikimin e heroinës shumë herë e më shumë se vitet e mëparshme, si dhe krijuan lidhje të forta me vendet furnizuese të Azisë Qendrore. Situata e luftërave dhe kaosi i shkaktuar në vendet e Ballkanit konfliktual pas viteve 90-të rritën intensitetin dhe operimin e fushave të veprimit të grupeve kriminale turke, duke i kthyer ato në kontrolluesit e fortë të trafikimit të heroinës në Europë. Ja vlen të theksohet fakti që, grupet kriminale turke përdorin metodën e pastrimit të të ardhurave si rezultat i trafikimit të heroinës, në biznese të ligjshme dhe nëpërmjet transaksioneve bankare. Për sa i përket mënyrës së strukturës të këtyre grupeve kriminale turke ajo ka qenë historikisht hierarkike dhe homogjene, por viteve të fundit është vënë re një bashkëpunim i tyre me grupe të tjera kriminale që operojnë në Europë. Fushat në të cilën operon krimi i organizuar në Turqi janë: trafikimi i drogës, i qenieve njerëzore, kontrabanda, falsifikimi i parave, grabitjet, krime të rënda kundër shtetit (Michaletos: 2007).

Si përfundim për sa i përket shfaqjes së krimit të organizuar në Shqipëri, ajo ka ardhur si rezultat i disa faktorëve të rëndësishëm shoqëror, ekonomik dhe politik. Ndryshimi i sistemit nga ai komunist në atë pluralist ka ndikuar në krijimin e lehtësirave për operimin e këtyre veprimtarive kriminale, sepse periudha e tranzicionin gjithmonë shoqërohet me institucione të dobëta, me ekonomi të brishta dhe nga një nivel i ulët i reagimit institucional. Gjithashtu mund të themi që kriza ekonomike e viteve 1997-të e cila u shoqërua me rritje të nivelit të lartë të papunësisë dhe shkallës së lartë të informalitetit, krijuan rrethana të favorshme dhe lehtësuese për operimin e krimit të organizuar. Një faktor shumë i rëndësishëm është edhe pozita gjeografike e Shqipërisë, "midis vendeve prodhuese të drogës së fortë në Lindje, siç janë Afganistani dhe Turqia, dhe vendeve konsumatore në Perëndim, siç janë shtetet anëtare të BE-së (Zhillla & Lamallari, 2015: 19). Mënyra e strukturimit të grupeve kriminale shqiptare pas viteve 2005 është në formën e rrjeteve kriminale, por duke ruajtur autonominë e grupit. Veprimtaritë e këtyre grupeve janë: trafikimi i drogës, kryesisht kanabisit, trafikimi i qenieve njerëzore (femrat për qëllime prostitucioni), trafikimi i armëve, vjedhjet, grabitjet etj.

Politikat qeveritare në kufizimin e operimit të veprimtarive kriminale dhe sfidat e së ardhmes

Pranohet gjerësisht se krimi i organizuar në vendet e Europës Juglindore kërcënojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut, stabilitetin etj. Operimi i këtyre veprimtarive kriminale në këto shoqëri në tranzicion ka rritur impaktin e tyre edhe përtej kufijve të Europës Juglindore. Për pasojë është krijuar një pasiguri e madhe e brendshme për vetë këto vende, por

edhe një pasiguri e madhe dhe problematike për sigurinë e vendeve të Bashkimit Europian. Në optikën e Bashkimit Europian, politika e zgjerimit përmes anëtarësimit të vendeve të tjera, përfshirë dhe anëtarësimin e këtyre vendeve në të ardhmen, nga njëra anë është parë si një mundësi e mirë për të rritur sigurinë e përbashkët dhe përballimin e këtyre sfidave apo kërcënimeve, por nga ana tjetër, pranimi dhe integrimi i këtyre shteteve e sjell Bashkimin Europian më afër zonave problematike. Vendet e rajonit si pasojë e ndryshimeve të sistemeve të tyre politike si dhe të luftërave të zhvilluara pas viteve 90-të në Ballkan u përballën me kriminalitetin në një shkallë të gjerë, u përballën me grupe kriminale, të cilat kryenin aktivitete të tilla si, trafikimi i lëndëve narkotike, trafikimi i qenieve njerëzore (për shfrytëzim seksual, emigrimi ilegal, trafikimi i armëve etj, duke i kthyer ato në furnizuesit kryesor të këtyre trafikëve për vendet e Europës Perëndimore. Për këto arsye, Bashkimi Europian është shprehur vazhdimisht i gatshëm të ndihmojë shtetet që e aspirojnë integrimin, me synim forcimin e institucioneve të tyre, zhvillimin ekonomik, bashkëpunimin rajonal në çështje të cilat lidhen me sigurimin e kufijve dhe menaxhimin e tyre si dhe implementimin e strategjive për Mbrojtjen e Përbashkët Europiane në fushën e Sigurisë. Gjithsesi përgjegjësia kryesore bie mbi vetë shtetet e rajonit, përgjegjësia dhe detyra e Bashkimit Europian lidhet vetëm me këshillat, asistencën dhe ndihmën e saj për të vënë në dispozicion të këtyre shteteve, modelin europian të Mbrojtjes dhe Menaxhimit të Kufijve.

Qeveritë e shteteve si Kroacia, Shqipëria, Serbia dhe Turqia vazhdimisht kanë bërë përpjekje për të përmirësuar situatën duke ndjekur strategji të cilat kufizojnë operimin e krimit të organizuar në vendin e tyre. Për sa i përket Kroacisë, duhet të theksohet fakti që pavarësisht se pas viteve 90-të u gjend në të njëjtat rrethana problematike ku vihej re rritja e intensitetit të operimit të veprimtarive kriminale të shkaktuara nga lufta dhe periudha e tranzicionit, ajo lëvizti dhe vazhdon të lëvizë më hap më të shpejtë dhe të sigurt se vendet e tjera të rajonit për sa i përket krijimit të politikave dhe strategjive efikase kundër krimit të organizuar. Politikat qeveritare kroate rezultuan efikase në adaptimin e rregulloreve të nevojshme për ngritjen dhe vënien në funksion të një sistemi të zbatimit të ligjit si dhe në krijimin e një bazë të dhënash mbi krimin, në ndryshim p.sh: nga Shqipëria dhe Serbia ku atyre vazhdimisht u kërkohet nga vendet anëtare të Bashkimit Europian dokumentimi i të dhënave të besueshme, rezultate dhe qëndrueshmëri për sa i përket luftës kundër krimit të organizuar. Pavarësisht se vihet re një gatishmëri dhe vendosmëri e qeverisë shqiptare ndër vite për luftën kundër krimit të organizuar dhe arritje e rezultateve të mira p.sh: në çmontimin e disa organizatave kriminale, arrestimin e personave me profil të lartë kriminal apo në shkatërrimin e kultivimit të kanabisit në shumë zona të Shqipërisë (Projekti Rajonal Carpo, 2006: 71), ende nuk janë arritur objektivat e duhura dhe ende ka një mungesë dhe qëndrueshmëri në raportimin e të dhënave të besueshme. E njëjta situatë paraqitet edhe në Serbi, ku pavarësisht rezultateve pozitive në disa raste ku mund të përmendim këtu operacionet e zbatimit të ligjit, të cilat i dhanë fund Klanit të Zemunit apo adoptimi i Kodit të ri penal që hyri në fuqi në 1 Janar 2006, i cili përmban përkufizime ligjore të “krimit të organizuar”, “grupeve të krimit të organizuar” dhe “grupeve të tjera të krimit të organizuar” (Projekti Rajonal Carpo, 2006: 97), ende nuk janë arritur rezultatet e pritura dhe vihet re një mungesë e theksuar e mekanizmit të të dhënave të besueshme dhe të qëndrueshme në luftën kundër krimit të organizuar. Ndërsa për sa i përket politikave qeveritare në Turqi, vihen re përmirësimi i programeve të mëparshme dhe një riorganizim i institucioneve në luftën kundër krimit të organizuar. Gjithashtu, Turqia ka vënë në veprim në vitin 2013 një plan veprimi kundër operimit të veprimtarive kriminale si dhe ka rritur nivelin e bashkëpunimit me vendet e rajonit, me vendet e Bashkimit europian si dhe është bërë pjesë e organizmave ndërkombëtarë që merren me luftën kundër krimit të organizuar. Pavarësisht arritjeve dhe rezultateve shumë pozitive të arritura, duhet theksuar fakti që Turqia vazhdon ende të mbetet një nga vendet kryesore të trafikimit të heroinës në vendet e Bashkimit Europian dhe më gjerë.

Konkluzione/Rekomandime

Krimi i organizuar është kthyer në një sfidë madhore sigurie në ditët e sotme. Kjo për faktin e rritjes së nivelit të operimit të veprimtarive kriminale jo vetëm brenda kufijve të shteteve ku operojnë, por edhe përtej kufijve të tyre duke i dhënë atyre një nivel global. Për sa i përket vendeve të cilat u morën në trajtim gjatë këtij punimi, mund të themi që duhet të tregohet akoma edhe më shumë vendosmëri nga qeveritë e vendeve, nevojitet një koordinim më i madh ndërmjet institucioneve në luftën kundër krimit të organizuar, sepse pavarësisht përpjekjeve pozitive nuk janë arritur akoma objektivat e duhura. Gjithashtu duhet theksuar fakti që lufta kundër krimit të organizuar nuk mund të arrijë suksesin e duhur në rast se nuk ekziston fryma e vërtetë e bashkëpunimit me fqinjët. Bashkëpunimi rajonal nuk duhet të mbesë thjeshtë në kuptimin sipërfaqësor të të thënit në deklarata të ndryshme të kërreëve të këtyre qeverive, apo thjeshtë në firmosjen e marrëveshjeve rajonale bashkëpunuese në kuadër të realizimit të kritereve apo kushteve për arritjen e objektivit, atë të integritetit të tyre në Bashkimin Europian, por ajo duhet të kuptohet vërtetë si një përgjegjësi dhe e mirë e sigurisë së përbashkët. E them këtë, sepse vihet re një mungesë e theksuar dëshire nga ana e shteteve që kanë rezultuar të suksesshëm në adaptimin efikas të strategjive të Bashkimit Europian ndaj luftës kundër krimit të organizuar, për të ndarë eksperiencën e tyre me vendet e tjera të cilat akoma nuk kanë arritur nivelin e duhur. Nuk është zgjedhur në mënyrë të rastësishme Kroacia në këtë punim, është marrë në shqyrtim pikërisht për të treguar se si një vend i cili gjendej në të njëjtat kushte problematike siç ishte Shqipëria, Serbia, Maqedonia, Bosnje-Herzegovina apo Mali i Zi pas viteve 90-të, arriti që të përparonte më shpejt dhe të bëhej pjesë e Bashkimit Europian. Lufta kundër krimit të organizuar për këto vende rezultoi se do të jetë një sfidë e madhe dhe e gjatë, por jo e perealizueshme. Në rast se ndiqen dhe zbatohen me përpikëri strategjitë dhe planet e veprimit, në rast se do të të rritet akoma e më shumë fryma e ndërgjegjësimit për një bashkëpunim real ndërmjet shteteve fqinje do të mund të arrihet minimizimi i operimit të këtyre veprimtarive kriminale si dhe do të mund të arrihet siguria më e lartë për të gjitha këto vende.

Bibliografia

- Council Of Europe & European Commission: Projekti Rajonal Carpo “ Raporti mbi gjendjen e Krimet të Oraganizuar dhe Krimet Ekonomik në Europën Juglindore”, Strasburg, Gusht 2006.
- Hysa, Vasilika: “Kriminologjia”, Kristalina, Tiranë 2005.
- Michaletos, Ioannis: “Turkish Organized Crime”, Worldpress.org. November 12. Athens-Greece 2007.
- Stojarova, Vera: “Organized Crime in the Western Balkans”, Humsec Journal, Issue 1. Graz 2007.
- Zhilla. Fabian & Lamallari. Besfort: “ Krimi i Organizuar, Vlerësimi i riskut në Shqipëri, Fondacioni shoqëria e hapur për Shqipërinë, Tiranë 2015.
- Wall, David: “Crime and the internet”, Routledge Londër& New- York 2002.

FENOMENI ISIS - PËRTEJ NJË KONFLIKTI TË ARMATOSUR (DILEMA TË KOMUNIKIMIT SOCIAL-KULTUROPËRË NË ÇËSHTJE TË SIGURISË)

PROF. DR. KRISTAQ XHARO

DR. MIMOZA DUKA

ABSTRAKT

Koalicioni kundër Shtetit Islamik (ISIS), që formalisht nisi në Qershor 2014, shfaqet i konsoliduar dhe superior në teatrin konvencional të operacionit. Operacioni dukshëm paraqet tregues të progresit, por ende larg mundësisë të një triumfi përfundimtar. Konflikti krahas përballjes në luftim shfaq ende shumë çështje të rëndësishme, të cilat direkt apo indirekt janë pjesë të angazhimit të koalicionit. Mbetën ende nën mjegull dilema që lidhen me natyrën e konfliktit, burimet e tij, aktorët dhe faktorët, motivet dhe frymëzimet, mënyra e reflektimit në skenën rajonale dhe më gjerë. Për rrjedhojë ato dhe të tjera nuk kufizohen vetëm në natyrën ushtarake të zgjidhjes së problemit ngaqë hapësira e tyre shtrihet më larg se rrezja e raketave dhe po aq e pa orientuar sa shpërndarja e shpërthimeve kamikaze të eksplozivave.

Mbi 12 000 luftëtarë nga 81 vende të botës i janë bashkuar konfliktit në Siri-Irak. Termi “foreign fighters” nuk përfaqëson tashmë një simbolikë, por një dukuri që nuk duket se ka përfunduar. Beteja kundër ISIS po tregon se më shume se një konflikt i armatosur midis një koalicioni të fuqishëm ndërkombëtar kundër potencialeve konvencionale, ajo është edhe një betejë e natyre më të komplikuar. Kalifati apo ndryshe “state of mind” ka kufij më të gjerë e më të rrezikshëm se ato gjeografik. Në këtë kontekst, çdo vend dallon specifikisht në kushtet e vlerësimit të situatës apo të mjeteve që do të mund të adresojnë për këtë problem. Dhe kjo betejë që shumica e vendeve, në Lindje e Perëndim, sot e në një të ardhme jo të afërt do të ndeshen, duket se në fund të fundit lidhet me rrënjët e thella sociale-kulturore të problemit, që për hir të së vërtetës shumica preferojnë ti anashkalojnë ose injorojnë. Vendi ynë, por edhe në tërësi trojet shqiptare ndodhen jo larg llavës së kësaj dileme.

Autorët në këtë trajtesë janë përpjekur të sjellin background-in e konfliktit dhe nëpërmjet analizës të afrojnë vlerësime për çështje të sigurisë në nivel kombëtar dhe rajonal. Një analizë e fenomenit ISIS dhe rrjeteve të tjera terroriste në atë rajon, shfaqjes së “foreign fighters” dhe mundësisë së tyre për tu kthyer në vendet e origjinës, çon në një disbalancë midis impaktit dhe burimeve të kufizuara për tu përballur. Autorët besojnë që përballja duhet bazuar në të kuptuarit e plotë të fenomenit e më tej në ndërtimin e një strategjie afatgjatë për trajtimin e problemit.

Fjalë kyç: ISIS - Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë; “Foreign fighters” - Luftëtarë të huaj; Al Qaeda - Organizatë terroriste; Khalifa (Kalifat) - Formë organizimi e regjimit Islamik

Hyrje

Grupi ISIS (Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë), i krijuar në Prill 2013 me prejardhje nga grupi Al Qaida në Irak (AQI) është grupi më radikal krahasuar me të gjithë grupet e militantëve islamikë, që operojnë në Lindjen e Mesme dhe grupi islamist më i pasur financiarisht në botë. Tashmë ai zotëron një arsenal armatimi të krahasueshëm me atë të një ushtrie konvencionale. Një arsenal i tillë kërkon njohuri në përdorim dhe mirëmbajtje që ISIS nuk i disponon, çka mund të çojë grupimin në nevojë rekrutimesh individësh me background ushtarak deri dhe me pagesa marramendëse për trajnime. Aktualisht ISIS është grupi militant me influencë me të madhe edhe në rang ndërkombëtar dhe shpallja e shtetit islamik përbën një kërcënim real jo vetëm për paqen në Lindjen e Mesme, por për sigurinë rajonale e globale pasi mund të shndërrohet në një inkubator terroristësh për të planifikuar sulme në vendet perëndimore apo eksportuar celula në vendet e origjinës së militantëve që i janë bashkuar.

Shpallja e shtetit islamik, gjerësia e territoreve nën kontrollin e tij dhe përpjekjet për të funksionuar si entitet shtetëror, makabritetet e kryera ndaj pengjeve perëndimore dhe sekteve të tjera të vetë fesë islame, fushata e paparë propagandistike e mediatike kanë vënë grupimin nën një vëmendje të paparë ndërkombëtare si një kërcënim potencial në rritje. Aktet e fundit terroriste në Paris, shfarosja e pesëmbëdhjetë fshatrave nga grupi i kryesuar nga Boko Haram në Nigeri me synim krijimin e një shteti islamik atje, indikacionet për akte terroriste edhe në Spanjë e vende të tjera perëndimore janë një sirenë alarmi për dimensionin ndërkombëtar të një vale eminente kërcënimi terrorist.

Përballja më këtë kërcënim real në rritje kërkon koordinim përpjekjesh konkrete në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare, zgjerim dhe angazhim aktiv të koalicionit ndërkombëtar kundër ISIS por edhe bashkëpunim të frytshëm dhe aktiv të institucioneve të sigurisë për të orientuar vendimmarrjen strategjike për politika parandaluese dhe monitoruese afatgjata.

Kontingjentet që tashmë veprojnë në kontekstin e ISIS janë nga më hetoregjenët. Përveç hapësirës ku shtrihet gjeografikisht ISIS, një numër jashtëzakonisht i konsiderueshëm vijnë nga vende të tjera përfshirë ato perëndimore. “Foreign fighters” nuk i lidh një emërues i përbashkët. Besimi, motivi, interesi, e deri tek aventura janë elementë të frymëzimit të tyre për pjesëmarrje në zonën e konfliktit.

Për rrjedhojë, çështja, tashmë, nuk shtrohet vetëm në mposhtjen territoriale të shtetit islamik (kalifatit) por në mposhtjen e burimeve që iniciuan dhe realizuan këtë fenomen. Edhe më delikate paraqitetet ISIS në analizën e kushteve sociale, politike, ekonomike, religjioze etj., të cilat mund të shërbejnë për rishfaqjen e fenomenit në të ardhmen në këtë zonë apo edhe në rajone të tjera. Siç shkruan Marina Ottaway, nga Woodroë Wilson International Center for Scholars “ISIS – shumë pamje – shumë përballje” “... Më e rëndësishmja aspektet e ndryshme të ISIS nuk mund të luftohen me të njëjtat mënyra dhe me të njëjtat mjete...”.

Analizën për konfliktin në Irak- Siri ose ndryshe për ISIS në funksion të ndikimit të tij në çështjet e sigurisë synojmë ta zhvillojmë në tre drejtime kryesore. **Së pari** ISIS si një Prot-State ose ndryshe si një tip- shteti i cili kontrollon territore në Siri dhe Irak. Kufijtë e këtij shteti janë vazhdimisht të kontestuara dhe shkalla e kontrollit të lidhshpimit aktual mbi këtë territor mbetet e paqartë. Por, sipas liderve të ISIS ekziston një territor, me pjesë të Sirisë dhe Irakut dhe ky shtet është kalifati.

Sidoqoftë ky shtet që pretendohet, sipas analistëve nuk është aspekti më kërcënues i ISIS, përjashtuar për njerëzit që banojnë në të apo në afërsi të tij. Shumë më e rrezikshme është **aspekti i dytë** i ISIS, që shfaqet si pjesë e një rrjeti apo rrjeteve të grupeve radikale islamike, që operojnë në botën myslimane e më gjerë. Suksesi i Shtetit Islamik dhe vëmendja, që ai ka grumbulluar nëpërmjet kontrollit territorial kanë krijuar frymëzimin dhe ambicien për grupet e tjera për të deklaruar aleancën me këtë shtet. Nuk është e qartë se për çfarë aleance bëhet fjalë. A nënkupton kjo që ata kanë krijuar lidhje hierarkie me ISIS dhe presin urdhra prej tij, apo grupet ruajnë autonominë dhe koordinojnë veprimet. Apo më tej a marrin mbështetje financiare nga ISIS, apo paguajnë për ISIS; a kanë krijuar këto grupe kanale për lëvizjen e “foreign fighters”?. E më tej, në mos thjeshtë këto grupe kërkojnë të rrisin propagandën për legjitimitetin e xhihadit. Ende nuk ka përgjigje të plota për këto pyetje.

Së treti, ISIS duket diçka më mjegullt se këto rrjete. Për ndryshe nga këto përcaktime ISIS në territorin që pretendon mund të përcaktohet si “state of mind” ose ndryshe “shtet i premtuar” (në kuptimin hyjnor) i cili ju afrohet pjesëmarrësve “në një gjendje mendore” pas një akumulimi të pakënaqësisë, të fyerjeve dhe poshtërimeve, zemërimit, të zhgënjimit, të idealizmit te më të rinjve, të entuziazmit fetar dhe të dëshirës për një alternativë ekzaltuese përballë një jete të dërrmuar pa asnjë të ardhme. “State of mind” tërheq mijëra të rinj (por edhe të reja) nga vendet myslimane, por edhe ato perëndimore për të luftuar në Siri dhe Irak, apo për të kryer akte terroriste në vendet e tyre në emër të idealeve të humbura apo objektivave të papërcaktuara.

Të tri këto aspekte sigurisht, që janë të lidhura, por jo në mënyra që janë përherë të qarta. Kur të rinj të dëshpëruar myslimanë udhëtojnë drejt Sirisë dhe Irakut, ata e bëjnë për t’ju bashkuar një organizate specifike të quajtur ISIS. Por kur ata kthehen në vendet e tyre dhe ndërmarrin akte terroriste në Perëndim, ata jo domosdoshmërisht veprojnë nën urdhrat e ISIS apo të ndonjë organizate tjetër. Dhe nëse Shteti Islamik, në një të ardhme, do të shkatërrohet dhe humbas territoret e tij, organizata të tjera radikale mund të deklarojnë shkëputjen nga aleanca e mëparshme e kalojnë në një grupim të ri, siç ndodhi midis al-Qaeda dhe ISIS. Pra vijnë në vlerësimin se aspekte të ndryshme të ISIS nuk mund të luftohen me të njëjtat mjete e mënyra.

Lindja dhe evoluimi i fenomenit ISIS. Vështrim historik

Në vitet 1990 Ebu Mus’ab el-Zarkawi themeloi grupin terrorist El-Tewhid Wel-Jihad, si një kundërshti ndaj pranisë së forcave ushtarake të SHBA dhe atyre perëndimore në botën islame dhe si kundërpërgjigje ndaj mbështetjes së perëndimit për Izraelin. Ai udhëhoqi grupin deri në vdekjen e tij në qershor të vitit 2006 duke e transformuar atë në një degë të rëndësishme

të Al-Qaeda në Irak. Bashkimi me Al-Qaeda në realizua në fund të vitit 2003 dhe Al-Zarkawi u zotua për besnikëri ndaj Osama bin Laden. Pas kësaj, grupi El-Tewhid Wel-Jihadi u bë i njohur si Al-Qaeda në Irak (AQI), dhe Al-Zarkawi-t iu dha titulli “Emir i Al-Qaeda në “shtetin e dy lumenjve”. Në mes të tetorit 2006, pasardhësi i Ebu Mus’ab el-Zarqawit, Ebu Ejub el-Masri, vendosi si qëllim të grupit krijimin e një kalifati në rajon, duke deklaruar se luftonte për “Shtetin Islamik të Irakut” (ISI), emër me të cilin më pas do të identifikohet vetë AQI. Ky ndryshim emri dhe strategjie tregojnë se AQI/ISI tashmë kishte dhe një synim të qartë politik, se lufta e saj nuk do ishte më vetëm kundër “pushtuesve”, por dhe kundër të gjithë atyre që do të kundërshtonin *kalifatin*. Në vitin 2011, ISI u shndërrua në grupin më të madh e më të fuqishëm ekstremist suni në Irak. Grupi mbajti një rrjet logjistik në të gjithë Lindjen e Mesme, Afrikën e Veriut, Iran, Azinë Jugore, dhe Evropë.

Në prill 2013, ISI u transformua në Shteti Islamik i Irakut dhe Levante (ISIL) ose ndryshe shteti Islamik i Irakut dhe al-Sham (ISIS). Me krijimin e ISIS/ISIL dhe me tentativën e ISIL për të bashkuar nën një komandë të gjitha grupet xhihadiste në rajon, kundërshtia më e madhe për këtë shkrimje erdhi nga mbështetësit e Al Nusrah, të cilët u ndanë në dy fraksione: një grup ruajti emrin e tij origjinal (Al-Nusrah), ndërsa një grup tjetër iu bashkua komandës së Ebu Bakr al-Bagdadi. Nga fragmentarizmi i Al-Nusrah-s nisën dhe përplasjet e para për pushtet mes grupeve duke detyruar kreun e Al Kaedës, Ayman al Za’ahiri, të anulonte shkrimjen e grupeve dhe t’i udhëzonte krerët e tyre që të përmbahen nga rivaliteti. Duke përfutur nga konflikti në Siri, ISIS ka shtuar radhët e militantëve të tij.

Në 29 qershor 2014, udhëheqësit e ISIS-it shpallën krijimin e Shtetit Islamik, me kufi nga qyteti Dayala në lindje të Irakut deri në qytetin Aleppo në veri të Sirisë.

FIGURA 1. PAMJE TE SHTRIRJES SE KONFLIKTIT (AL JAZEERA, 30 JUN 2014)



Pretendimet e tyre për një afat disa vjeçar përfshijnë krijimin e një *kalifati më të madh, territori i të cilit përfshin një pjesë të madhe të Azisë Qendrore, të gjithë Lindjen e Mesme, Afrikën Veriore si dhe gadishullin Ballkanik dhe Iberik. Gjithashtu, ata ndryshuan edhe emrin e grupit nga ISIS në “Shteti Islamik”, si dhe caktuan si udhëheqës Abu Bakar Al Baghdadi-n, drejtuesin aktual të këtij grupi, të vetë quajtur tashmë Kalifi Ibrahim*. Në deklaratën e shpalljes së Shtetit Islamik iu kërkohet të gjithë myslimanëve të betohen për besnikëri ndaj kalifit të tyre.

Al Baghdadi kërkon gjithashtu shkrimjen e grupimeve dhe bashkimin nën shtetin islamik.¹ Ky fraksion i rrezikshëm edhe radikal i Al Qaeda ka masakruar pjesëtarët e pakicës fetare Yazidi të Irakut, ka mbuluar elementin mediatik të vrasjeve të gazetarëve të kapur perëndimorë dhe punonjës humanitarë, dhe ka filluar tashmë një fushatë terrori kundër çdo fisi lokal që guxon të kundërshtojë sundimin e tij. Shteti Islamik i Irakut dhe Levante ISIS/ISIL grabit deri në 1 milion dollarë në ditë dhe ka nën urdhrat e tij një vëllim të burimeve dhe një hapësirë territori të pashoqe në historinë e organizatave ekstremiste.² Shpejtësia dhe shkalla e përparimit të ISIS kanë qenë shumë të larta, ndërkohë që pasuria e grupit xhihadist llogaritet në mbi 2 miliardë dollarë. ISIS e siguron një buxhet kaq të madh, përmes zhvatjeve, drogës, rrëmbimeve, pastrimit të parave, taksave që i viheshin bizneseve lokale, shitjes së energjisë elektrike, naftës, ndihmës së donatorëve dhe rezervave të mëdha të floririt të vjedhura në banka.

ISIS grumbullon para përmes teknikave që janë më të njohura nga organizata mafioze, se sa nga grupe revolucionare apo xhihadiste.³ ISIS nxjerr gjithashtu një raport vjetor të aktiviteteve të tij, ku thekson sukseset e tij operacionale dhe territoret që zgjeron, i cili besohet se është një përpjekje e tij për t’i reklamuar efikasitetin e grupit donatorëve potencialë, simpatizues

www. Opensource.gov/ Analysis on ISIS, “ Give good news to the believers ”The declaration of the Islamic State in Iraq and Al-Sham”

Një deklaratë audio nga Amir Al-Muminin Abu Bakr Al-Hussaini Al-Quraishi Al-Baghdadi.” **Përveç shpalljes së shtetit islamik, kufijve dhe objektivave të tij, me** këtë deklaratë, thuhet se “nën emrin e Shtetit Islamik të Irakut edhe emri i Jabhat Al Nusra do të venitet me dëshirën e Allahut dhe ata do mbeten pjesë e historisë së xhihadit tonë të bekuar si të parët para kësaj, dhe në të njëjtën kohë i shtrijmë krahët dhe hapim zemrat ndaj fraksioneve duke bërë xhihad për hir të Allahut të Ploftuqishëm dhe fiset krenar në vendin e bekuar të Al- Shamit, për të bërë fjalën e Allahut më të lartë dhe populli dhe toka të drejtohet nga ligjet e Allahut ..”

Janine Davidson and Emerson Brookings at Counsel for foreign relations, available at www.cfr.org › About CFR › Leadership and Staff.

Stuart Gottlieb, “Four reasons ISIS is a threat to US homeland” available at “The national interest Magazine” 20 Shtator 2014;

të kauzës së tij. Deri tani SHBA ka ndërmarrë një fushatë sulmesh ajrore në Irak dhe Siri. Pentagoni njoftoi se 1 500 trupa të tjerë amerikane do të shkojnë në Irak për të këshilluar dhe ndihmuar forcat irakiane dhe kurde. Faktori ndërkombëtar ka harmonizuar përpjekjet nëpërmjet një koalicioni ndërkombëtar kundër ISIS ku vendi ynë është rreshtuar me kontribut konkret krahas partnerëve ndërkombëtare.

ISIS ka theksuar ambicien e tij për t'u bërë një tregues i përhershëm në hartën e Lindjes së Mesme. Grupi nuk do të kishte qenë në gjendje të realizonte një shtrirje kaq të madhe, të paraqesë apo pretendojë të funksionojë si një entitet shtetëror, i aftë për të kontrolluar territore dhe ushtruar pushtet mbi një popullsi prej miliona, në qoftë se ai nuk do kishte qenë i armatosur plotësisht, pjesërisht prej konfiskimit të pajisjeve ushtarake nga të larguarit nga ushtria irakiane dhe plaçkitja e bazave ushtarake siriane. Kur ISIS pushtoi Mosulin, qyteti i dytë më i madh i Irakut, në qershor, arriti të shtjerë në dorë aq armatime sa u armatos grupi si një ushtri konvencionale.⁴ **Shtimi i radhëve të grupimit me militantë, gjerësia e territoreve nën kontrollin e tyre, makabritetet e kryera ndaj pengjeve perëndimore dhe fiseve kundërshtarë të tyre, përdorimi i gjerë i rrjeteve dhe mediave sociale, propaganda mediatike nëpërmjet marrjes “së përzgjedhur” të pengjeve dhe ekzekutimit monstruoz të tyre, përpjekjet për të funksionuar si entitet shtetëror, kanë vënë grupimin nën një vëmendje të paparë ndërkombëtare si një kërcënim potencial në rritje.**

ISIS si një mit apo realitet. ISIS si një proto-state

Territori i ISIS të cilin Abu Bakr al-Baghdadi e deklaroi si një kalifat, në qershor 2014 varijon në përmasa sa Belgjika sipas *The Wall Street Journal* deri në përmasat e Jordanisë sipas George Packer në *The New Yorker*. Pavarësisht nga përmasat kalifati ka filluar të duket gjithmonë e më shumë si një shtet. Kalifati i vet deklaruar shtrihet nga kryeqyteti de-fakto Raka në Sirinë Veriore duke kaluar përmes kufirit të humbur me Irakun në qytetet Mosul, Tikrit, dhe Falluxha deri në periferi të Bagdatit duke kapur 1/3 e territorit të Sirisë dhe Irakut të marrë së bashku. Sipas Fuad Hussein⁵ ai shprehet se ISIS kontrollon 1/3 e Irakut dhe 1/3 e Sirisë pra rreth 250 mijë kilometër katrorë,, që është gati një sipërfaqe sa Britania e Madhe. Me një popullsi prej 10-12 milion banorë, ISIS ka një hapësirë të madhe për të rekrutuar trupa të tjera.

Debati sot zhvillohet nëse e gjithë kjo sipërfaqe e kontrolluar mund të konsiderohet vërtet një shtet. Mjaft analistë duke cituar Max Weber në fillim të shekullit të 20-të që një shtet modern kërkon më së paku monopolin “...e legjitimitetit të përdorimit të forcës fizike ...brenda territorit...”. Në këtë analizë Tarek Masoud nga Harvard kundërshton “ Fakti që ISIS e thërret vetveten shtet nuk mjafton që ai të konsiderohet i tillë. Veber ka patur diçka mjaft më shumë në mendje se një grup psikopatësh... Në të njëjtën kohë Veber patjetër që kish diçka më shumë në mendje se çfarë Siria dhe Iraku duken nën qeverisjen aktuale. Aktualisht rajoni vuan shumë më tepër nga mungesa e ligjit sesa nga përdorimi i forcës.

Në vijim edhe pse ISIS mbetet një organizatë terroriste në gjithë themelet, përpjekjet e tij për të krijuar një model shteti në Siri dhe Irak kanë demonstruar shkallën e objektivave dhe të kapaciteteve të tij. Duke zgjeruar valët e egra të destabilitetit në rajon nëpërmjet akteve terroriste, ISIS në mënyrë të suksesshme ka fituar fuqi ushtarake, vëmendje ndërkombëtare dhe burime të paprecedenta financiare. Burime të ndryshme paraqesin se ISIS zotëron, sipas CIA-s një forcë ushtarake që shkon në rreth 32 000 trupa nga të cilat rreth 15 000 vlerësohet të jenë “foreign fighters”. Kjo shifër shpesh kundërshtohet duke e çuar numrin deri mbi 100 mijë trupa. Ndërsa shefi i shtabit të forcave kurde Fuad Hussein në një intervistë për *The Independent on Sunday* shprehet që “ unë vlerësoj për rreth 100 mijë trupa nisur nga fakti që ISIS mund të mobilizojnë të rinj arab në territoret që kanë kapur...”⁶ Sipas të dhënave më të fundit, ISIS posedon armatim të tipit prodhim sovjetik, armatim amerikan, armë të prodhuara në Kinë, vende të Ballkanit dhe Iran. Nga një studim i bërë nga Jeremy Binder dhe Armin Rosen,⁷ dhe një seri studimesh të tjera, ISIS posedon armatim të mjaftueshëm për një ushtri konvencionale. Në këtë arsenal bëjnë pjesë:

Tanke të tipit T-55: Është vlerësuar se ISIS ka rreth 30 tanke T-55. Pavarësisht vjetërsisë, ky tip tanku mbetet operacional në 50 ushtri në gjithë botën.

Tanke të tipit T-62: ISIS ka rreth 15 tanke T-62. Ky tip tanku sovjetik ishte futur në përdorim për të zëvendësuar T-55. Është përdorur gjerësisht nga irakianët gjatë luftës Iran-Irak.

Tanke të tipit T-72: Militantët kanë rreth 5-10 tanke T-72 që i përket gjeneratës së dytë sovjetike të tankeve të luftimit.

Mjete të blinduara BRDM-2: Xhihadistët kanë kapur rreth 6 mjete të tilla. BRDM-2 është mjet i blinduar patrullimi, i prodhuar fillimisht në 1961 nga ish sovjetikët.

Mjete të blinduara MT-LB: ISIS besohet se ka 2 mjete MT-LB, të dyja të kapura në Irak. MT-LB është mjet sekondar amfib i blinduar.

Mjete luftarake këmbësorie BMP-1: ISIS besohet të ketë 20 automjete të tilla luftarake të këmbësorisë në arsenalin e tij. BMP-1 është një mjet amfib sovjetik.

Artileri vetëlëvizëse 122mm 2S1 Gvozdika : ISIS ka rreth tre 2S1 Gvozdika që është artileri vetëlëvizëse. Kjo e bën atë shumë të manovrueshëm dhe amfib.

Item

Fuad Hussein shef i shtabit të forcave kurde
<http://www.independent.co.uk/news/world/>

Jeremy Bender and Armin Rosen, 17 nëntor 2014, <http://www.businessinsider.com/>.
commons.wikimedia.org, see also defenseone.

Automjete të blinduara: ISIS zotëron një seri automjetesh të blinduara rëndë, të prodhuara në SHBA, kur bastisën Mosulin. Automjete të tilla i ishin dhënë ushtrisë irakiane nga SHBA.

AK-47: Edhe pse ISIS nuk ka një armë të vetme të preferuar, AK-47 është shndërruar në armën standarde të grupit për shkak të kostos së ulët, qëndrueshmërisë, disponueshmërinë, dhe lehtësinë e përdorimit.

Armë të tjera në arsenal të forcave të ISIS mund të përmendim : *Top 82mm B-10 ; Top 105mm M40* ¹⁰, **Raket-hedhës M79 Osa; Granat-hedhës RBG-6** ¹¹; *G-7*¹²; **Raketa hedhës i shumëfishtë**¹³; **M198 Hoëitzer; Top mbushës 59-1** ¹⁴; **Top D-30; Top Kundërajror ZU-23-2; Kundërajror vetëlëvizës 23mm ZSU-23-4 ;A-16 ;Raketa antitanke HJ-8; DShK 1938 Machine Gun; Avionë luftarakë MiG:** Është shumë e dyshimtë që ISIS të ketë aftësinë e fluturimit të avionëve luftarakë të tipit MiG, por e sigurt se kanë rënë në dorë të tyre gjatë betejës mbi Taqaba. Nuk dihet as gjendja e tyre luftarake.

ISIS ka kapur mjaft armatim që me shumë gjasa nuk ka ekspertizë ushtarake për t'i vënë në veprim, duke përfshirë një version rus të raketave amerikane goditje anësore e grabitur në betejën e Taqaba dhe një raketë balistike në Raqqa në Siri. Megjithatë, mediat sociale të vetë ISIS-it paraqesin luftëtarët e ISIS në MiG - 21B pas beteje ¹⁵. Një arsenal i tillë armatimi, kërkon njohuri në përdorim dhe mirëmbajtje që sipas të dhënave të shërbimeve të inteligjencës, ISIS nuk i disponon, çka mund të çojë grupimin në nevojë rekrutimesh individësh me background ushtarak deri dhe me pagesa marramendëse për trajnime. Një kampion alarmi dhe “mundësi” për shërbimet e inteligjencës civile dhe ushtarake për të orientuar grumbullimin e informacionit dhe deri penetrime në radhët e grupimit për të marrë informacion mbi taktikat dhe teknikat që ka grupimi për realizimin e objektivave.

ISIS – Si një organizim me frymëzim radikal religjioz. Dilema të komunikimit social kulturor

Shteti islamik pretendon se ka rivendosur një *kalifat* në përputhje me metodën profetike. Historiani Edëard Luttëak shprehet se shteti islamik vetëm kërkon frymëzimin e tij nga katër kalifët e parë që pasuan profetin Muhamed. Sipas Luttëak, as kalifi më i fuqishëm, kalifi Abbasis, nuk është model i këtij shteti islamik. Po të shihet propaganda e shtetit islamik do shihet që qysh nga themelimi, grupi ka kërkuar të risjellë ditët e lavdishme të kalifit Abbasid në Baghdad, kryesisht në kohën e Harun al-Rashid të 1001 netëve të famshme. ¹⁶

“E di se Bagdadi i al- Rashidit është shtëpia e kalifatit që paraardhësit tanë ndërtuan”, deklaroi një zëdhënës i Shtetit Islamik. “Kjo nuk do të shfaqet nga duart tona, por me anë të trupave tona dhe kokave të prera. Ne edhe një herë do të mbjellim flamurin e monoteizmit, flamurin e shtetit islam në të.”¹⁷ Në të njëjtin vit, al- Bagdadi njoftoi: “Sot, ne jemi në shtëpinë e kalifatit Bagdadin e al-Rashidit.”¹⁸. Sipas studiuesve, plani i Shtetit Islamik për të ringjallur kalifin Abbasit në Bagdad ka dy probleme:

E para është ideologjike: Harun al-Rashid nuk njihet si ideologjikisht i devotshëm, atij i pëlqente poezia, dhe ata që e rrethonin vlerësonin debatin intelektual dhe kulturën e tij pagane, të cilat janë në fakt anatemë e salafistëve ultrakonservativë, si këta që “qeverisin” sot shtetin e shpallur islamik. Por duket se ata duan t'i ngjajnë pushtetit të al - Rashidit dhe jo ideologjisë së tij profetike.

Problemi i dytë është i karakterit demografik, i cili nuk mund të zgjidhet nga një memorie selektive. Shumica e banorëve të Bagdadit janë të sektit shiit. Ata nuk do heqin dore pa luftë, nuk do dorëzohen kaq kollaj as vetë padronët e tyre në Iran. Nisur nga argumentet e dhëna më lart është në fakt çmenduri të pretendosh të marrësh Bagdadin përveç se të konsolidojë atë pushtet që ka në rajonet me shumicë sunitë.¹⁹

Në deklaratat dhe web faqet e ISIS është publikuar edhe një master plan i shtetit islamik i quajtur “ *the ten state solution*” që grafikisht jepet në figurën e mëposhtme. ²⁰

Long war Journal, www.longwarjournal.org; “Isis launch parade”, 2014.

Christofer Harris “ISIS weapons growing in number, sophistication; A sovjet, Ballkan and american mix but the group cant use all of them” 5 Dhjetor 2014, International Bussines Times magazine.

Brown Moses, brown-moses.blogspot.com. Njihet si gazetar investigativ, i cili ka dhënë një kontribut domethënës me informacionet e grumbulluara dhe fotot e realizuara nga terreni për ISIS.

Item

Robert Fairly; The national interest. September 25,2014 “ Five ISIS weapons of warr America should fear” 25 Shtator 2014.

Item.

#Syria #Raqqa #Islamic State fighters infront of MIG jet inside a shelter of #Tabqa airbase pic.twitter.com/tKD8XmdLL5— Mark (@markito0171) August 24, 2014

Fraza “al-Rashid” nuk është një epitë i zakonshëm për t’iu referuar Bagdadit, gjendet vetëm në librat e mesjetës. Në diskutimet moderne fraza “ Baghdadi i al-Rashid-it” është kontrast i “ Damascus of al-Walid,” një nga kalifët Umayyad të asaj kohe.

Muharib al-Jaburi, “al-`Ilan `an qiyam dawlat al-`Iraq al-Islamiyya,” 15 January 2007.

Abu Umar al-Baghdadi, “Wa-yamkurun wa-yamkur Allah,” 15 September 2007.

Haylamaz, Resit,” Abu Bakr : The Pinnacle of Truthfulness (Paperback)”2013,pp 147.

Walid Shoebat, referuar nga Jack Moore, InternationalL business time, 2 shtator 2014.”Ten state solution” nënkupton dhjetë shtetet e dekadës tjetër.

Harta ka ngjallur diskutime midis teologëve islamë. Ëalid Shoebat, një ish anëtar i ish-organizatës për çlirimin e Palestinës (PLO), i kthyer tashmë në një teolog islam, e ka përkthyer në këtë mënyrë hartën “dhjetë shtetet e dekadës tjetër.”²¹

FIGURA 3 WALID SHOEBAT: 10 SHTETET E DEKADES TJETER



Në hartën e mësipërme, e cila është shpjegim teologjik i master planit “*ten state solution*” shteti islamik ka objektiva afatgjatë shtrirjeje deri në Ballkan, Spanjë, Portugali. Ballkani pretendohet të jetë nën “Orobpa” dhe Portugalia dhe Spanja nën “Andalus”. Sipas kësaj harte Kurdistan, Iraku dhe Siria (Sham) do të jenë shtetet e para objektive të kalifatit, së bashku me Libanin, nën emërtimin Sham. Shtete të tjera që do mund të vihen nën kalifat, sipas shpjegimit të po këtij teologu, në fazën e dytë do të jenë Turqia ose (anadoli) dhe shtetet e quajtura Gogaz që përfshijnë Azerbaixhanin, Kazakistanin, Kyrgyzstanin, Turkmenistanin, Tashkistanin dhe Uzbekistanin. Në Khurasan do të bjenë Irani, Afganistani, Pakistani dhe potencialisht Indonezia, ndërsa Hijaz do përfshijë shtetet e gjirit dhe Yemeni. Nën Qinan do jetë Egjipti, Sudani dhe Somalia, ndërsa nën Magreb do jenë shtete e Afrikës së Veriut, si Libia, Tunizia, Algjeri, Maroku dhe Mauritania.

Harta e shpallur nga shteti islamik shtrihet edhe në gadishullin e Ballkanit. Sa mistike dhe reale mund të jetë ajo?! Edhe kjo hartë sipas studiuesve të sigurisë ka probleme dhe duket më tepër një hartë propagandistike për të nxitur besimtarët e këtyre vendeve dhe shtuar radhët e rekrutëve militantë. Ballkani njihet si vend i diversitetit të kulturave, etnive, kombësive dhe në komunitetet myslimane feja myslimane tradicionale e shkollës Medhebi Hanefi është ajo mbizotëruese. Pavarësisht efektit propagandistik dhe fantazisë që ky master plan mund të ketë, nuk duhet të ngelet jashtë vëmendjes së analistëve të inteligjencës për parashikime afatgjata për të parandaluar krijimin e vatrave të veçuara të tipit IS ballkanik. Në fakt është hera e parë në historinë e grupimeve të tilla terroriste që japin një hartë të cinguar jo globale siç pretendon në strategjitë e saj Al-Qaeda.

Përveç përfshirjes në këtë hartë të Ballkanit, është tashmë fakt që shumë vullnetarë nga Ballkani i janë bashkuar grupimeve radikale islamiste në Siri dhe me bashkimin e Al Nusras me ISIS një pjesë e tyre i janë bashkuar grupimit, pra një taktikë propagandistike për efekte rekrutimi apo një strategji reale... A përbën harta e shpallur e ISIS-it një mit apo kërcënim real është një çështje, që nuk duhet të kalojë e pa analizuar nga shërbimet e inteligjencës së këtyre vendeve, të cilat duhet të bashkërendojnë shkëmbimin e informacionit për këtë kërcënim të përbashkët që pa dyshim nuk mund të përballet i vetëm.

Vlerësime afatgjata janë të nevojshme, të cilat analistët e inteligjencës do duhet të ofrojnë vendimmarrjes për të koordinuar përpjekjet dhe maksimalizuar efektshmërinë parandaluese dhe monitoruese të këtij fenomeni. Strukturat kundër zbuluese do duhet të fokusohen realisht në këtë kërcënim dhe pa dyshim që kjo nuk mund të zgjidhet me kundërzbulim pasiv mbrojtës. Nevoja për kundërzbulimin ofensiv nuk ka mbaruar, është një realitet pa fund. Koordinimi gjithashtu duhet të jetë i pandërprerë, i institucionalizuar duke lënë pas “ortodoksinë” që shpesh i karakterizon shërbimet e inteligjencës në shkëmbimin e informacionit. Kërcënimi terrorist kërkon një kundërzbulim ofensiv, koordinim përpjekjesh dhe shkëmbim informacioni në kohë mes njësisve operacionale, sisteme bazash të dhënash të aksesueshme për institucionet përgjegjëse, struktura analitike profesionale të afta për të analizuar dhe integruar çdo pjesëz informacioni për të vepruar në kohë para se kërcënimi të vijë real në dyert tona....

Por le t'i kthehemi shpalljes së *Kalifatit Islamik*, nga lideri i ISIS, Abu Bakr al-Baghdadi, i cili ka bërë një reklamim të tij si lidhësi i lëvizjes globale xhihadiste. Ai nuk ka kërkuar vetëm që çdo mysliman t'i pretojë besnikëri atij si *kalifi* i ri, por ka asnjansuar gjithashtu legjitimitetin e çdo grupi apo aleance tjetër islamiste, duke përfshirë edhe grupin e Al Qaedës që i qëndron besnik Ayman al-Zaëhirit, pasardhësit të Osama Bin Laden-it. Vetëshpallja e al-Baghdadit si *kalif*, është shumë e debatuar në komunitetin e gjerë islam, pasi në botën islame nuk ka pasur një *kalif* që kur Perandoria Osmane doli jashtë sektit Ahmadiya, ku figura e kalifit është përcaktuar si i vetmi pasardhës legjitim i profetit Muhamed. Fakti që ISIS e bëri këtë, pritet të sjellë ndërlkime shumë të mëdha ideologjike dhe teologjike dhe përbën një sfidë të madhe edhe për vetë Al-Qaeda. ISIS deklaroi se i konsideron të pavlefshme organizatat e tjera jashtë *Kalifatit*. Kjo paraqet një sfidë të madhe për grupimet e tjera të lidhura me Al-Qaeda që janë ende besnikë të Zaëhirit, duke përfshirë këtu edhe degën e njohur për Sirinë, Jabhat al-Nusra. Abu Bakr al-Baghdadi ka llogaritur se mbështetja e rritur ndaj grupit të tij do të rrisë ndërkombëtarisht peshën e

Jack Moore, International business time, 2 shtator 2014, referuar Walid Shoebat.

grupit, duke ia kaluar edhe vetë “kupolës” së Al-Qaeda dhe bashkëpunëtorëve të saj, veçanërisht pasi ai ka pushtet të vërtetë ushtarak dhe burime financiare.

Kjo lojë për pushtet mes grupeve radikale islamiste mund të ketë pasoja që lidhen me faktin se grupet e tjera të rajonit janë duke vlerësuar situatën dhe mënyrën se si mund të përgjigjen. Ndërkohë ISIS edhe pse fraksion i Al-Qaedaë dallon nga ajo pasi qëllimet e tyre janë të lokalizuara gjeografikisht. Ndërsa Al-Qaeda aspiron për xhihad global, ISIS i ka të përcaktuar dhe shpallur tashmë kufijtë e shtetit islamik. Në këtë drejtim, një krahasim më i argumentuar do ishte me talebanët. Siç e dimë, Al-Qaeda ishte në gjendje për të vepruar në Afganistan sepse talebanët ishin në pushtet, dhe kishin të sanksionuar praninë e tyre. Nëse ISIS do të ketë sukses në krijimin dhe qëndrueshmërinë e një kalifati islamik, ekziston një rrezik real global. Territorët nën zotërimin e tij do të mund të shndërrohet në një port të sigurt për grupet terroriste me besime të ngjashme por me objektiva më globale, duke ofruar kështu një “safe even” për të planifikuar dhe trajnuar për sulmet në të gjithë botën.

Teorikisht armiku vendos kur një luftë mbaron. ISIS do të ketë humbur kur të mos ketë më strehë të sigurt, kur nuk do mund të sigurojë më financa, kur nuk do mund të realizojë rekrutime të reja dhe kur të rinjtë ekstremistë apo të zhgënjyer të largohen dhe kthehen në shtëpi. Por edhe atëherë lufta me siguri nuk do të konsiderohet e mbaruar. Industria terroriste ende do të përfitojë nga të rinjtë si degët e Al-Qaedaë kanë bërë në të gjithë Lindjen e Mesme dhe Afrikë, për të përfshirë Al-Qaidën në Gadishullin Arabik, Magrebin islamik, Al-Shabab, Al-Nusra, Grupi Khorasan, dhe madje edhe në Indi, duke themeluar kështu një cikim xhihadistësh. Shkatërrimi i ISIS nuk është i mjaftueshëm; Amerika është duke zhvilluar një luftë kundër terrorizmit, dhe ISIS është vetëm manifestim i radhës i kërcënimit.²²

Pa një Lindje të Mesme stabël paqja globale mbetet e rrezikuar. Grupet terroriste do vazhdojnë të gjejnë copëza “safe havens” apo të krijojnë të tilla, në Afganistan, më pas në Yemen, Somali, Nigeri etj. Ka qenë pjesë e debatit politik e akademik të cilët kanë bërë thirrje për Shtetet e Bashkuara për rikthim me trupa në Irak pas tërheqjes në 2011 “për të vënë çizme në terren”. Për disa studiues *një prani më e madhe tokësore amerikane mund të shërbejë si një mjet i madh rekrutimi për udhëheqjen e ISIS dhe do çojë koston e jetës së amerikanëve në një betejë të pambarim.*²³

Shpallja e Shtetit Islamik konsiderohet edhe si një tentativë e Abu Bakar Al-Baghdadit për të konsoliduar pushtetin e tij mbi grupet e tjera të kryengritësve, futjen nën ombrellën e ISIS-it të të gjitha grupeve të tjera të militantëve në Lindjen e Mesme deri tejkalimin e Al-Qaedaë. Sipas disa dokumenteve të gjetura pas vrasjes së Ossama Bin Ladeni-t, mendohet se është gjetur edhe një porosi e vetë kryeterroristit, ku u thuhet anëtarëve të organizatës të mos bien pre e fraksioneve që do të pretendojnë të dëmtojnë imazhin dhe objektivat strategjike të Al-Qaedaë që janë xhihad global.²⁴

ISIS përbën tashmë një rrezik potencial për sigurinë në nivel lokal, rajonal deri dhe global. Në nivelin global, pas deklarimit të Kalifatit dhe pretendimit të një roli udhëheqës mes grupeve xhihadiste në botë, ISIS tashmë paraqet një rrezik për sigurinë ndërkombëtare. Në deklaratën e fundit të bërë nga krerë të ISIS, janë bërë kërcënime të drejtpërdrejta ndaj vendeve perëndimore në përgjithësi me fokus të veçantë në Angli, Francë. Një kërcënim real të konsiderohet i tillë duhet të ketë tre elementë: synim, kapacitete dhe mundësi. Qartësisht ISIS ka synim të shprehur, deri edhe kanë deklaruar në videot e prodhuara si pjesë e fushatës së tyre propaganduese që “*flamuri i zi do të fluturojë i lirë mbi shtëpinë e bardhë*”. Sado fantazi e shfrenuar të duket, nuk duhet të kalojë jashtë vëmendjes së shërbimeve të inteligjencës.

Akti terrorist i 11 shtatorit tregoi mbarë botës rrezikun terrorist dhe vuri në agjendë të parë luftën kundër terrorizmit. Pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit, pati shumë debate mbi atë që komuniteti i inteligjencës amerikane dështoi në parandalimin e këtij akti. “11 shtatori ishte rezultat i një dështimi katastrofik të inteligjencës, nuk duhej të kishte ndodhur, dhe ishin të gjitha mundësitë të parandalohesh”²⁵. Por ky dështim u analizua dhe u bë nxitje për reformime rrënjësore të komunitetit të inteligjencës amerikane dhe jo vetëm. Edhe në ditët e sotme me shpalljen e shtetit islamik, kanë filluar tashmë debatet në qarqet akademike, duke kritikuar komunitetin e inteligjencës amerikane për mosparashikim të përmasave që mund të merrte grupimi i Al-Qaedaë në Irak, drejtuar nga Al-Baghdadi. A është realisht ky dështim i inteligjencës apo i vendimmarrjes politike do mbetet për një farë kohe pjesë e debateve publike në qarqe ndërkombëtare, pasi dihet tashmë aksioma e famshme që institucionet e inteligjencës do përmenden vetëm për dështimet.

ISIS ka kapacitete financiare për të mbuluar blerjet e armatimeve, financuar rekrutimet dhe deri thithjen e mercenarëve me pagesë, ka arritur të zotërojë sasi shumë të madhe territori nga ku mund të shndërrohet në inkubator për terroristët. Shteti islamik mund të shndërrohet edhe si kauzë frymëzimi për individë të veçuar në vendet perëndimore, të cilët mund të ndërmarin akte të veçuara terroriste kundër targeteve që mund t’u japin atyre përparësi mbulimi mediatik për rrjedhojë impakt të gjerë. Kohët e fundit bota po përballet me virusin Ebola, i cili ka marrë dhe vazhdon të marrë jetë njerëzish në vendet e Afrikës. Sipas disa raportimeve ka të dhëna të pakonfirmuara ende se disa militantë të ISIS janë prekur nga virusi, të cilin mund ta kenë marrë nga udhëtimet drejt vendeve të tyre të origjinës. Mungesa e kapaciteteve mjekësore për të identifikuar dhe marrë masat e nevojshme në kufijtë e shpallur të shtetit islamik, mund të shndërrohet në një rrezik me impakt më të gjerë. Nëse militantët do shtinin në dorë virusin, atëherë ai do shndërrohet në armën biologjike më të rrezikshme, duke përbërë kështu një rrezik real global.

Stuart Gottlieb, The national Interest magazine, “Four reasons ISIS is a threat to America homeland” September 20, 2014. Autori konkludon se “Fakti që grupe si ISIS mendojnë dhe veprojnë gjithmonë në terma synimesh sa lokale aq edhe globale e bën atë kërcënim potencial.

Mark Wiggins, KVUE ;” Analysis: ISIS domestic threat foreign solutions “ 2014
www.OpenSource.gov (Information to Intelligence).

Anthony Glee, “9/11: an intelligence failure and its consequences” Posted on, September 11, 2011 by Drejtor i BUCSIS në Universitetin e

Buckingham. Anthony Glee MA MPhil DPhil (Oxford) drejton prej kohësh Qendrën e Studimeve për çështje të sigurisë dhe Inteligjencës.

“Transformimi i Madh: 25 vjet përvoja shqiptare e tranzicionit dhe demokratizimit”

Foreign Fighters” - vullnetarë të huaj zhvillim specifik në rajonin e konfliktit. Refleksione në çështje të sigurisë

Që me fillimin e konfliktit në Siri një numër i madh vullnetarësh i janë bashkuar grupimeve radikale. Një pjesë e këtyre luftëtarëve i janë bashkuar tashmë Shtetit Islamik dhe janë zhvendosur në Irak përkrah ISIS. Moshë më e ndeshur e vullnetarëve është 18-29 vjeç edhe pse ka shumë raste të moshës 15-17 vjeç, apo edhe tek të 30-ta. Kjo moshë është më e re se ajo e vullnetarëve të “xhihadit” në Afganistan, ku më e ndeshura ishte 25-30 vjeç. Pothuajse të gjithë ata që shkojnë në Siri janë meshkuj (dhe pse një numër i kufizuar grash), veçanërisht nga vendet perëndimore, që janë bashkuar shoqërisë, bashkëshortëve, apo kanë udhëtuar për llogari të tyre në Siri. Shumica e vullnetarëve janë pa përgatitje ushtarake dhe pa ndonjë eksperiencë të mëparshme luftimi edhe pse ka një bërthamë me vullnetarë të vjetër, që kanë luftuar në fronte të tjera. Këta individë i janë bashkuar grupeve ekstremiste, ose kanë formuar njësitë e tyre. Disa luftëtarë më të rinj, vijnë me trajnim bazë. Luftëtarët e Hezbollahut dhe anëtarët e Forcës al-Quds të Gardës Revolucionare Iraniane, mbërrijnë të mirë trajnuar. Një numër i konsiderueshëm i rekrutëve nga vendet Perëndimore janë të rinj të fesë islame. Mesatarisht 6% e vullnetarëve nga vendet e BE-së, janë të konvertuar.²⁶ Shumë vullnetarë nga vendet perëndimore janë brezi i dytë dhe i tretë i emigrantëve të ardhur në këto vende.

Megjithëse ka shumë klipe në dispozicion që tregojnë luftëtarë me grupet ekstremiste duke kryer akte të tmerrshme vrasje dhe represioni, pamjet e përgjithshme të ofruara nga vullnetarët për jetën e tyre në Siri flasin për aktivitete të motivuara, të gjitha këto të përziera me një ndjenjë heroizmi, për të tërhequr shokët dhe për t'i dhënë kuptim imazhit të tyre.

Ndër këta vullnetarë konstatohet një numër i madh edhe nga Ballkani, përfshi vendet shqipfolëse. Një pjesë e tyre nga zonat rurale, të varfëra dhe me nivel arsimor të ulët. Është shqetësues fakti që kësaj radhe teatri i konfliktit sirian përfshiu një numër më të madh se çdo herë tjetër vullnetarësh shqipfolës. Burimet e hapura të informacionit flasin edhe për një “brigadë të Ballkanit” që është më shumë mediatike dhe ka efekt propagandues apo synim ambiciesh të disa prej liderëve të tyre të vetëshpallur si të tillë për të zënë dhe fituar influencë në radhët e grupimit.

Motivimet janë të shumta duke filluar nga nevoja ekonomike, papunësia, injoranca e kulturës së shëndoshë fetare. Media sociale gjithashtu ka luajtur rol domethënës. Komentet e rekrutëve të huaj në mediat sociale, e paraqesin Sirinë si tokë të “xhihadit”. Mundësia dhe dëshira për të marrë pjesë në një betejë të profetizuar, si 1.400 vjet më parë, është ende një motiv i fortë. Për disa të tjerë, mundësia që të vdesin si “martir”, duke luftuar armikun e pafe, do të shpërblehet në jetën e përtejme. Të jesh “xhihadist”, do të thotë të jesh i obliguar për të ndihmuar komunitetin mysliman që është aktualisht i sulmuar. Ky është motivi qendror i ekstremizmit islamik, që nga koha e Al-Kaedës në vitet 1990. Në mediat sociale qarkullojnë postime, raportime të bëra nga luftëtarët për krimet e kryera apo ndodhi të tjera të luftës civile në Siri. Për këtë temë ka një ndjeshmëri të madhe, krahasuar me çështje të tjera që i referohen politikës, kulturës, sportit, ekonomisë etj. Një analizë e 22.000 postimeve në twitter gjatë të njëjtës periudhë, lidhur me aktivitetin e vullnetarëve të huaj, tregojnë një nivel të lartë të përgjigjeve të drejtpërdrejta, që në fakt tejkalojnë postimet dhe ri-postimet, tregues ky i një shkallë të pazakontë interesimi dhe angazhimi për këtë problem.²⁷

Një tërheqje tjetër është mundësia për të jetuar në një vend ku rregullat dhe sjellja janë vetëm në përputhje me mësimet e Islamit. Njohuritë e tyre për fenë janë rudimentare dhe kështu ata nuk e vënë në dyshim autoritetin e udhëheqësve të tyre dhe i besojnë verbërisht për ato që thonë. Kjo mënyrë jetese jep ndikimin e saj të fortë në karakterin e vullnetarëve dhe pasqyrohet edhe kur ata kthehen në vendet e tyre apo shkojnë në vende të tjera. Mund të ketë edhe ndonjë që për motive të tjera është më pak i përkushtuar. Disa e shohin luftën si një mundësi për aventurë, për arratisje nga vendi ku janë, apo për përfitime financiare. Shumë të tjerë, mund të mos jenë në gjendje të thonë se përse ata kanë vendosur të marrin pjesë në luftë.

Ecuria nga vullnetar në terrorist nuk është lineare, as dhe e pashmangshme dhe shumica e njerëzve që kthehen nga lufta në Siri mund të mos jenë kërcënim terrorist, vështirësia është se si mund të dallohen ato.²⁸ Liderët e shumë grupeve ekstremistë kanë treguar se nuk kanë hezituar për sulme kërcënuese terroriste si në vendet me shumicë myslimane ashtu edhe në ato me shumicë jo-myslimane. Pothuajse të gjithë ata që luftuan kundër Bashkimit Sovjetik në Afganistan u bënë terroristë më pas, megjithëse rrethanat ishin të ndryshme.²⁹ Kur njerëzit shkuan në Afganistan gjatë periudhës së Talebanëve, ata nuk kishin koncept të zhvilluar për Al-Qaeda dhe terrorizmin lokal e global. Kjo u arrit atëherë kuar ata u njohën me argumentet e Bin Laden-it për të sulmuar “*armikun larg*”.

Ndërsa tani, luftëtarët e huaj që shkojnë në Siri janë të vetëdijshëm për atë se çfarë është Al-Qaeda dhe e dinë shumë mirë se përse grupet ekstremiste qëndrojnë me të, kështu që edhe pse ata mund të shkojnë vetëm me qëllimin për të luftuar regjimin, ka më shumë gjasa të jenë të gatshëm për të pranuar doktrinën e Al-Qaidës dhe grupeve të lidhura, më shumë se paraardhësit e tyre që ishin në Afganistan. Edhe duke supozuar se disa luftëtarë shkojnë në Siri pa menduar pasojat se mund të bashkohen me një grup ekstremist, atëherë lind pyetja se përse ata qëndrojnë atje. Ka pasur raste kur vullnetarët që kanë dezertuar janë vrarë. Lufta e Sirisë ka të ngjarë që të jetë një inkubator për një brez të ri terroristësh. Mungesa e politikave të përshtatshme për t'i dhënë fund luftës, mungesa e politikave bashkëkohore për luftëtarët që kthehen, si dhe dështimi i

Joseph A. Carter; Shiraz Maher; Peter R. Neumann in The international center for the study of radicalization and political violence(ICSR) report “ “Measuring Importance and Influence in Syrian Foreign Fighter Networks”page 13
Item page 27

Foreign fighters in Iraq and Syria: Where do they come from,available at <https://www.ctc.usma.edu/.../foreign-fighters-from-the-Hayrudin-Somun-at-Today's-Zaman,-'Mujahideen'-from-Balkans-in-Syria> available at www.todayzaman.com/op-ed_mujahideen-from-balka.

përprjekjeve për t'i penguar vullnetarët të shkojnë ndaj përprjekjeve që nxisin për të shkuar në Siri, e kanë rritur konfuzionin ndërkombëtar për problemet e paraqitura nga ekstremizmi fetar. ³⁰Shumë luftëtarë të huaj deklarojnë se nuk kanë ndërmend të kthehen në shtëpi apo të lënë Sirinë. Ka shumë klipe që i tregojnë ata duke djegur pasaportat në shenjë refuzimi simbolik të njohjes së shtetit nga ata vijnë dhe qenie tashmë pjesë të shtetit islamik *ku do sundojë ligji i sheriatit*. Pati video ku edhe vullnetarë nga Kosova dogjën pasaportën kosovare.

Tashmë situata ka evoluar, ISIS ka shpallur shtetin islamik, po tenton të ndërtojë mekanizma të funksionimit si entitet shtetëror, duke u bërë kështu pika fundore e përfundimit të vullnetarëve që janë aktualisht pjesë e terrenit të konfliktit në Siri. Sipas disa studiuesve ISIS-it i duhet edhe mbështetje në realizimin e strategjisë së tij, nisur edhe nga fakti që lideri i tij njihet si takticien ushtarak me aftësi të provuara, ekziston rreziku i organizmit të selektuar të kthimit të vullnetarëve dhe përdorimit të tyre për akte terroriste në vendet e origjinës ndoshta deri selektive për në vendet e koalicionit ndërkombëtar kundër ISIS. ³¹

Përfundime

1. Përveçse një kërcënim lokal e rajonal për paqen në Lindjen e mesme, shteti islamik përbën një kërcënim global. Pas deklarimit të Kalifatit dhe pretendimit të një roli udhëheqës mes grupeve xhihadiste në botë, ISIS tashmë paraqet një rrezik për sigurinë ndërkombëtare. Shteti islamik mund të shndërrohet në një inkubator terroristësh për të eksportuar militantë e planifikuar akte terroriste në vendet perëndimore, por edhe mund të shërbejë si kauzë frymëzimi për organizim aktesh terroriste nga individë të veçuar por me impakt të madh.
 2. Shteti Islamik ka theksuar ambicien e tij për t'u bërë një tregues i përhershëm në hartën e Lindjes së Mesme. Grupi nuk do të kishte qenë në gjendje të realizonte një shtrirje kaq të madhe ose të paraqesë veten si një entitet shtetëror, si e aftë për të kontrolluar territore dhe ushtruar pushtet mbi një popullsi prej miliona, në qoftë se ai nuk kishte qenë i armatosur plotësisht. ISIS zotëron një arsenal armatimi krahasueshëm me një ushtri konvencionale. Pjesë e arsenalit në zotërim kërkon njohuri në përdorim dhe mirëmbajtje që sipas të dhënave të shërbimeve të inteligjencës, ISIS nuk i disponon, çka mund ta çojë grupimin në nevojë rekrutimesh individësh me background ushtarak deri dhe me pagesa marramendëse për trajnime. Një kampion alarmi dhe "mundësi" kjo për institucionet e sigurisë për të orientuar grumbullimin e informacionit dhe penetrime në radhët e propaganduesve, rekrutuesve, financuesve deri te grupimi për të marrë informacion mbi taktikat dhe teknikat për realizimin e objektivave dhe mundësuar kështu monitorimin dhe parandalimin.
 3. Ndërsa Siria bëhet përherë e më e ndarë, grupet ekstremiste krijojnë rrënjë më të thella e strehë më të sigurt atje. Rreziku rritet jo vetëm në Siri, por edhe në vendet që luajnë pritësin për refugjatët sirianë. Refugjatët mund të jenë kategoria më e mundshme si target për rekrutime të mëtejshme.
 4. Në master planin "dhjetë shtetet e dekadës tjetër" të shtetit islamik përfshihet edhe Ballkani. Për herë të parë u përdor edhe gjuha shqipe në deklarata. Sado efekt propagandistik apo fantazi e shfrenuar mund të duket, nuk duhet vepruar sikur ngjarjet po ndodhin në një planet tjetër. Është tashmë fakt që shumë vullnetarë nga Ballkani i janë bashkuar grupimeve radikale islamiste në Siri dhe me bashkimin e Al Nusras me ISIS, një pjesë e tyre i janë bashkangjitur ISIS-it. Pavarësisht motiveve të vullnetarëve nga trevat shqipfolëse, tendencave në rënie për shkak edhe të masave dhe adresimeve ligjore, rreziku qëndron. Kthimi i tyre në vendet e origjinës mund të krijojë premisa për themelimin celulash radikale ekstremiste deri organizim aktesh terroriste. Përçarjet dhe ambiciet mes grupimeve për sferë influence mund të çojnë militantët shqipfolës në ndërmarrje aktesh terroriste edhe në vendet e tyre të origjinës si mjet "për t'u bërë prezent dhe krijuar identitet në radhët e ISIS-it".
 5. Është shqetësues fakti, që kësaj radhe teatri i konfliktit sirian përfshiu një numër më të madh se çdo herë tjetër vullnetarësh shqipfolës. Pavarësisht faktorëve dhe motiveve që i shtynjë të shkojnë në këtë rajon konflikti, kthimi i tyre në vend përbën një sfidë të shumëfishtë: sfidë për institucionet e sigurisë për të monitoruar aktivitetin e tyre në kthim, për të bërë diferencimin midis atyre që kthehen të zhgënjyer, të mashtruar dhe të bindur për t'iu kthyer jetës normale me ata që janë radikalizuar tashmë dhe kanë synime e plane konkrete; sfidë për institucionet e shtetit për të hartuar plane gjithëpërfshirëse për integrimin në jetën ekonomike dhe sociale të vendit, sfidë edhe për vetë komunitetin mysliman shqiptar për të elaboruar forma e metoda të predikimit dhe edukimit teologjik sipas islamit tradicional shqiptar, një shkollë fetare integruese e paqedashëse. Çështja e politikave dhe masave diferencuese mbi vullnetarët e kthyer nuk është vetëm një problem vetëm i yni, ballkanas, por edhe evropian e më gjerë, çka kërkon koordinim dhe bashkëpunim edhe për harmonizim të kuadrit ligjor në nivel rajonal. Mënyra e trajtimit nga autoritetet shtetërore të vullnetarëve të kthyer, do të ketë një ndikim të rëndësishëm në sjelljen e tyre në të ardhmen
- Roli i komunitetit ndërkombëtar është i rëndësishëm, si për integrimin e plotë të të kthyerve, ashtu edhe për identifikimin e menaxhimin e atyre që mund të paraqesin rrezik. Autoritetet shtetërore nuk mund ta bëjnë vetëm këtë. Atyre do t'u duhet ndihma e komunitetit ndërkombëtar për një monitorim afatgjatë të të kthyerve. Shqipëria nuk është immune ndaj këtij kërcënimi. Vendi ynë ka qenë pjesë e koalicionit ndërkombëtar "Liria e Irakut", pjesë e misionit të NATO-s, ISAF në Afganistan, është tashmë pjesë e koalicionit ndërkombëtar kundër shtetit islamik, dhe vendi ynë është i angazhuar me kontribut konkret në mbështetje e armatime qeverisë irakiane dhe

Mark Wiggins, KVUE ;" Analysis:ISIS domestic threat foreign solutions " 2014,

Sheldon Filger "Does the islamic state pose a threat to coalition partners against ISIS" available at www.opensource.gov.

kurdëve të Irakut. Pjesëmarrja e vendit tonë në këto koalicione ka gjetur mbështetje të gjerë në terrenin shqiptar. Nuk ka pasur asnjëherë deri më sot protesta kundër marrjes pjesë në Afganistan apo gjetkë, siç ka pasur raste në disa vende perëndimore. Faktori ynë politik e social është mbështetës i këtij kontributi domethënës që jep vendi në kuadër të sigurisë kolektive e globale. Por, gjithsesi përfshirja e Ballkanit në hartën e shpallur të shteti islamik, sado propagandistik të jetë, duhet të tërheqë vëmendjen e shërbimeve të inteligjencës për të adresuar analiza afatgjata në ndihmë të ndërtimit të politikave parandaluese.

Fakti që ISIS ka tashmë në arsenalin e tij armatim kryesisht të tipit ish sovjetik, kinez dhe nga Ballkani, duhet padyshim të tërheqë vëmendjen për të parandaluar rekrutime të mundshme në radhët e FA apo ish pjesëtarë të FA, njohës të përdorimit të këtij tipi lloj armatimi që ka qenë pjesë edhe e arsenalit tonë ushtarak. Është tashmë sfidë e këtyre strukturave të ndërtojnë kapacitete kundër zbuluese operacionale, të mirë trajnuara dhe afta të bëjnë së pari dallimin midis praktikantëve normalë të fesë islame me elementët radikalë me synime konkrete e ndërmarrë më pas operacione kundër zbuluese ofensive, të kombinuara pa dyshim me ato pasive, mbrojtëse.

Vizita e Papës së Shenjtë në vendin tonë, tregoi se institucionet e inteligjencës dhe sigurisë koordinuan dhe ofruan kushte sigurie maksimale për një vizitë tejet të suksesshme që do mbetet gjatë në memorien tonë historike. Institucionet e inteligjencës dhe sigurisë u angazhuan në një koordinim të paparë, shkëmbim informacioni në kohë dhe *pa asnjë xhelozë institucionale*. Mësimi i nxjerrë përtej një vizite, do ishte koordinim, bashkëpunim i vazhdueshëm deri operacione të përbashkëta midis institucioneve të inteligjencës civile, ushtarake dhe agjencive të zbatimit të ligjit, por edhe panele analitike të përbashkëta deri hartim vlerësimesh afatgjata të përbashkëta të kërcënimit ekstremist&terrorist në nivel vendi.

10. Aktet terroriste në France, aktet barbare nga grupi i kryesuar nga Boko Haram në Nigeri, situata në Jemen etj, me synim krijimin e një shteti islamik atje, indikacionet për akte terroriste edhe në vende të tjera perëndimore janë një sirenë alarmi për dimensionin ndërkombëtar të kërcënimit terrorist dhe një ridimensionim në çështjet e sigurisë.

Bibliografia

www. OpenSource.gov/ CIA information to intelligence /Analysis on ISIS.

Janine Davidson and Emerson Brookings at Counsel for foreign relations, available at www.cfr.org > About CFR > Leadership and Staff.

Stuart Gottlieb, "Four reasons ISIS is a threat to US homeland" available at "The national interest Magazine" 20 Shtator 2014.

Gayle Tzemach Lemmon, Defenseone: "The Search for the Plan To Destroy ISIS" November 27, 2014.

Jeremy Bender and Armin Rosen, 17 nëntor 2014, ëëë.businessinsider.com/2014-ixzz3JcEHSLOH.commons.ëikimedia.org.
Broën Moses, broën-moses.blogspot.com.

Robert Fairly; The national interest. September 25, 2014 " Five ISIS ëeapons of ëarr America should fear" 25 Shtator 2014.

Brent Parrish "The groëing ISIS arsenal" August 29, 2014, www.therightplanet.com

Muharib al-Jaburi, "al-'Ilan `an qiyam da'ëlat al-'Iraq al-Islamiyya," 15 January 2007.

Abu Umar al-Baghdadi, "Ëa-yamkurun ëa-yamkur Allah," 15 September 2007.

Haylamaz, Resit, "Abu Bakr : The Pinnacle of Truthfulness (Paperback)" 2013, pp 147.

Ëalid Shoebat, referuar nga Jack Moore, International business time, 2 shtator 2014.

Jack Moore, International business time, 2 shtator 2014.

Stuart Gottlieb, "The national Interest magazine," "Four reasons ISIS is a threat to America homeland" September 20, 2014.

Anthony Glees, "9/11: an intelligence failure and its consequences". Posted on

Joseph A. Carter; Shiraz Maher; Peter R. Neumann in The international center for the study of radicalization and political violence(ICSR) report " "Measuring Importance and Influence in Syrian Foreign Fighter Netëorks" page 13.

Mark Ëiggins, KVUE ;" Analysis: ISIS domestic threat foreign solutions " 2014,

Sheldon Filger "Does the islamic state pose a threat to coalition partners against ISIS" available at ëëë.opensource.gov.

Foreign fighters in Iraq and Syria: Ëhere do they come from, available at <https://www.ctc.usma.edu/.../foreign-fighters-from-the> Hayrudin

Somun at Today's Zaman, "Mujahideen' from Balkans in Syria" available at ëëë.todayszaman.com/op-ed_mujahideen-from-

IMPAKTI EUROPIAN NË POLITIKËN SHQIPTARE DHE MEKANIZMAT EUROPIANIZUESE

DOK. IRNA PESHKËPIA

ABSTRAKT

Ndërsa diskutojmë shpesh për impaktin që ka politika Europiane në politikën stabilizuese të vendit, shumë studiues janë të shqetësuar për nivelin e zhvillimeve Europiane në ditët e sotme. Një numër i madh studimesh në mënyrë eksplicite shprehin shqetësimin e procesit Europianizues në institucionet e brendshme duke paraqitur mungesë konsistente nëpërmjet politikave të brendshme dhe kushtëzimeve europiane. Qëllimi i këtij artikulli është të provojë më shumë struktura kompetitive duke argumentuar impaktin European në politikë-bërjen e brendshme të vendit. Duke argumentuar nëpërmjet një analize analitike mekanizmat Europianizues siç janë: përqasja institucionale, strukturat e brendshme dhe oportunitetet për ndryshimin e tyre, ku secila prej tyre kërkon një përjasje dalluese me qëllim që të argumentoj impaktin e brendshëm.

Analiza vazhdon me argumentet se këto faza të rëndësishme përfshijnë mekanizmat Europianizuese më shumë sesa politikën e brendshme të tyre në vetvete pasi është faktor i rëndësishëm për tu konsideruar kur heton ndikimin e brendshëm të politikave të ndryshme Europiane.

Fjalë kyç: *Europianizim, Integrim, politikë-bërje*

Hyrje

Bashkimi Europian, lidhur me zhvillimin e procesit integruar të vendeve është fokusuar në kushtet e brendshme në mënyrë që të ndikojë në ndërtimin institucional dhe krijimin e politikave, me nivelin në të cilën zbatimi i politikave evropiane nënkupton ndryshime në institucionet e brendshme të tilla si stilet dominuese, rregullatore dhe strukturat vendimmarrëse të veçanta në sektorët specifik.

Ky studim empirik dhe teorik do të analizojë impaktin Evropian i cili bën të mundur ndryshimet në sektorë të caktuar institucional dhe rëndësinë që kanë politikave evropiane në promovimin e reformave në vend. Observimi i politikave evropiane krijon mundësinë e përshtatjes së politikave të saj në vend edhe pse ky proces evropianizues nuk mund të ketë të njëjtën arritje në të gjitha vendet. Në anën tjetër, kemi një përjasje teorike për llojshmërinë e impaktit të procesit të integritimit evropian nëpërmjet marrëveshjeve të brendshme. Duke ju referuar disa studimeve do të arrijmë të identifikojmë se aftësia institucionale Evropiane për të ndikuar në marrëveshjet e brendshme ku niveli i kërkuar të arrijë të adaptohet në nivel Evropian si një variabël i rëndësishëm në strukturat e brendshme evropiane.

Qëllimi i këtij punimi është të tregoj një kornizë gjithëpërfshirëse të impaktit Evropian në politik-bërjen e saj. Nga ky këndvështrim sugjerojmë një diferencim dhe kualifikim të perspektivave ekzistuese duke identifikuar mekanizma të ndryshme Evropianizuese, ku çdo mekanizëm kërkon një përjasje dalluese për t'ju korresponduar ndryshimeve të brendshme.

Ne bëjmë një dallim analitik midis tre mekanizmave të evropianizimit:

Pajtueshmëria institucionale, mundësinë e ndryshimit në struktura të brendshme, dhe vëzhgimin e besueshmërisë së brendshme dhe pritshmëritë - secila prej tyre kërkon një qasje të veçantë në mënyrë që të shpjegojë ndikimin e saj.

Analiza vazhdon me argumentimin se baza dalluese e evropianizimit në vend në disa zona të veçanta politikë është faktori më i rëndësishëm për t'u konsideruar kur heton ndikimin e brendshëm të politikave të ndryshme evropiane. Në veçanti, ky dallim nisat nga studime të tjera të cilat identifikojnë presion për të përshtatur rregullimet e brendshme për të përmbushur kërkesat evropiane si kusht i nevojshëm për ndryshimin e brendshëm, pavarësisht nga mekanizmi themelor të evropianizimit. Për të ilustruar këto

argumente ne do të analizojmë mbi baza empirike tre fushat e politikave në të cilat tre mekanizma mund të vëzhgohet më qartë:

Pajtueshmëria institucionale,

Ndryshim në strukturat e brendshme

Mekanizmat evropianizimit do të ndikojnë në vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e tyre.

Modelet dalluese të evropianizimit

Hartimi i politikave evropiane mund të ndikojë mbi politikave të brendshme rregullatore dhe strukturat në tri mënyra themelore. Politikave evropiane mund të jenë: (a) shumë urdhëruese dhe kërkesat që shtetet anëtare të BE-së miratojnë masa të specifikuar në mënyrë që të plotësojnë kërkesat në përputhje me normat Evropiane; (b) i mbyllur për të ndryshuar mundësinë e strukturave të brendshme; (c) në formën e tyre më të dobët, pa ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë institucionale;

Shumë politika evropiane mund të jenë karakterizuar nga një përzjerje e mekanizmave të ndryshme të evropianizimit si mekanizmat dalluese janë të lidhura me njëra-tjetrën në një mënyrë hierarkike. Në këtë mënyrë impakti i një modeli institucional të brendshëm do të ndikojë përgjithësisht në strukturat e brendshme si dhe në pritshmërinë dhe besueshmërinë e aktorëve vendas. Në mënyrë eksplicite politika Evropiane mund të bëjë ndryshimet e brendshme duke përshkruar kërkesat specifike institucionale që çdo shtet anëtar duhet të plotësoj.

Mekanizmat e evropianizimit nga përputhshmëria institucionale është strategjia në politikave të ashtuquajturës 'integrimi pozitiv'² duke përfshirë mbrojtjen e një sërë reformash në fushën e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë, mbrojtjen e konsumatorit dhe pjesët e politikës sociale. Këto politika nënkuptojnë një ri-formësim të dispozitave ekzistuese të brendshme.³ Në mënyrë më pak të drejtpërdrejtë, legjislativi evropian mund të ndikojë në rregullimet e brendshme duke ndryshuar rregullat e brendshme të lojës. Ndikimi evropian është i mbyllur për të ndryshuar strukturat dhe mundësitë vendase.⁴ Ndryshime të tilla në strukturat e brendshme mundësojnë nga ana e ndërkombëtareve të ndikojnë në ekuilibrin e sfidave efektive të politikave ekzistuese. Ndërsa institucionet evropiane kontribuojnë në këto sfida të mundshme, ata nuk përshkruajnë ndonjë model të veçantë institucionale, por rezultojnë në një ekuilibër të ri. Kjo nuk do të thotë se politikave evropiane janë drejtuar drejt arritjes së objektivave të caktuara rregullatore kombëtare. Përkundrazi, ata kanë për qëllim për të arritur këto objektivat në një mënyrë më pak të drejtpërdrejtë, duke ndryshuar mundësinë e strukturave të brendshme në vend të rekomandimeve institucionale.

Ndikimi i Evropianizimit është përgjithësisht i kufizuar në marrëveshjet e brendshme administrative që shtrembërojnë funksionimin e tregut të përbashkët, të tilla si rregulloret kombëtare dhe mbrojtjen e ekonomisë ndaj konkurrencës së huaj.

Zhvillimi Institucional është një çështje e rëndësishme e procesit të integritimit evropian

Zhvillimi institucional shërben si kusht paraprak për hyrjen në BE-në. Vendet potencialisht kandidatë duhet të demonstrojnë stabilitet institucional që të garantojnë një rend demokratik dhe të ligjshëm, dhe duke respektuar të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve - sipas Kritereve politike.

Përveç kësaj, ata duhet të zbatojnë me sukses legjislacionin kombëtar, dhe të miratojnë synimet politike, ekonomike, dhe bashkimin monetar – sipas kriterëve ligjore (Hammerman dhe Schëeickert, 2005, Nëntor). Së fundi, vendet kandidatë duhet të kenë krijuar funksionimin e një tregu, si dhe aftësinë për të operuar në tregun konkurrues të BE-së – sipas Kriterit ekonomik

Këto të ashtuquajtura Kriteret e Kopenhagenit për anëtarësimin në BE të sigurojnë një nivel të caktuar të zhvillimit institucionale. Megjithatë, lind pyetja pse është i nevojshëm për BE-në për të kërkuar cilësinë institucionale si parakusht?

BE-ja është një subjekt shumë i integruar ekonomik dhe politik. Nëse një prej shteteve anëtare shkon në telashe, të tjerët do të ndikohen gjithashtu. Shtetet anëtare janë të lidhura ngushtë së bashku dhe vende me prejardhje shumë të ndryshme do të bashkohen nga BE-ja. Është dukshëm më e rëndësishme që BE të sigurojë që shtetet e reja anëtare të mbështesin parimet dhe vlerat për të cilat BE-ja dhe anëtarët e saj janë të angazhuar. Për këtë arsye, kriteri i cilësisë institucionale është një mjet i dobishëm për të kënaqur këtë kusht evropian.

Marrëveshjet reciproke do të çojnë në konkurrenca stabilizuese mes BE së dhe vendeve aspirante.

Prandaj, është e arsyeshme që BE-ja të kërkojë konvergjencën institucionale, në mënyrë që BE-ja të jetë më e fortë ekonomikisht dhe politikisht dhe, në këtë mënyrë, të bjerë kostot e vendimmarrjes tek vendet aspirante.

Përveç përfitimëve të BE-së, kërkesa e cilësisë institucionale mund të mundësojë një shtet më të fortë në mënyrë që të vendosi ligje të qëndrueshme demokratike dhe institucionet e veta.

Performanca dhe sfidat institucionale të Shqipërisë në kuadër të procesit të integritimit në BE-në

Shqipëria ka forcuar marrëdhëniet e saj me BE-në, duke përfunduar nënshkrimin e marrëveshjes së Stabilizim Asociimit si dhe duke qenë pjesë e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore. Integrimi evropian i Shqipërisë është një proces hap-pas-hapi që evoluon. Shqipëria, padyshim është etaloni i modelit të standardeve të BE-së. BE-ja ushtron dukshëm që Shqipëria të përmbushë kriteret e Kopenhagenit për të qenë pjesë e saj. Shqipëria ka bërë progres në adresimin e disa prej prioritetëve të saj, por ende përballet me shumë sfida të tjera. Prandaj në kuadër të kësaj analize lind pyetja sesa mirë e ka zhvillimin institucional Shqipëria në kuadër të integritimit evropian?

Shqipëria ka bërë progres në forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Shqipëria ka bërë disa përparime në forcimin e strukturave shtetërore për të koordinuar integritimin evropian. Megjithatë, forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe planifikimi strategjik mbetet ende për t'u përmirësuar. Në fushën e administratës publike, emërimet në shkelje të shërbimit civil kanë vazhduar, kryesisht duke përdorur kontrata të përkohshme. Mungesa e transparencës dhe llogaridhënies në emërimet mbetet një prioritet kyç i Partneritetit Evropian. Gjithashtu përpjekje të konsiderueshme janë prioritetet për të krijuar një shërbim civil të bazuar në merita të pavarura, efikase, dhe të paanshme politikisht.

Është bërë përparim i vogël në reformimin e sistemit gjyqësor. Pavarësisht vendosja e sistemit të përbarimit privat, një strategji gjithëpërfshirëse e reformës. Në përgjithësi, gjyqësori është i dobët për shkak të presionit politik, kërcënimeve, dhe korrupsioni i përhapur gjerësisht. Edhe pse dekriminalizimi është mekanizmi i duhur kundër kimit. Është dukshëm më e rëndësishme për të kënaqur këtë kërkesë kyçe të Partneritetit Evropian duke siguruar pavarësinë, transparencën dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor.

Korrupsioni përbën dështimin më dramatik të Shqipërisë. Qeveria ka bërë përpjekje për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin me zbatimin e strategjisë kundër korrupsionit dhe planin e veprimit, por me sa duket, forca e korrupsionit është e madhe. Ajo ka krijuar kaq shumë pasiguri për sipërmarrësit: pothuajse gjysma e firmave private pranojnë që të paguajnë ryshfet për zyrtarët publikë dhe ata kurrë nuk mund të jenë të sigurt kur ryshfeti është i mjaftueshme ose nëse zyrtarët e korruptuar do të mund të vijnë përsëri për të kërkuar më shumë para. Format më të zakonshme të korrupsionit në Shqipëri janë vjedhja e aseteve publike dhe fakti se shumica e vendeve të punës publike janë «blerë.» Është e nevojshme për të forcuar koordinimin e vendit në luftën kundër korrupsionit. Për më tepër, ajo është urgjente për të nxitur interesin publik në vend të politikanëve «dhe për të ndërtuar vullnetin politik për të mbështetur këtë zhvillim.

Deficite të mëdha Oportunitete të pakta

Sipas analizës së mësipërme, zhvillimi institucional shqiptar duket të jetë i mangët në krahasim me standardin e BE-së. Edhe pse shumë përpjekje janë bërë në përmbushjen e kriterëve të Kopenhagenit, mospërputhja ekziston dhe pyetja është se sa thellë kjo divergjencë është, dhe do të thotë më pak mundësi për t'ju bashkuar strukturave evropiane.

Natyrisht, siç është pritur nga përmirësimi i zhvillimit të institucioneve Shqiptare, institucionet juridike dhe administrative kanë një përmirësim më të keq në krahasim me ato legjislative. Rezultati i përgjithshëm i qeverisjes shqiptare është që përbën një mangësi në mënyrë dramatike të thellë në krahasim me atë të BE-në. Standardet e BE-së qëndrojnë aq larg atyre Shqiptare dhe kjo nuk është një shenjë e mirë dhe më pak mundësi për Shqipërinë. Qeveria shqiptare gjerësisht shpall se vendi është pranë fitimit të anëtarësimin në BE; megjithatë, anëtarësimi është ende një rrugë e gjatë.

Zhvillimi institucional paraqet një parakusht të rëndësishëm, i cili duhet të jetë i kënaqur nga vendet potencialisht anëtare që synojnë për të fituar anëtarësimin në familjen e madhe evropiane. Për këtë arsye, shteteve candidate u kërkohet të përmbushin një sërë kriteresh politike, ligjore, dhe ekonomike, të njohura zakonisht si kriteret e Kopenhagenit..

Arritja e këtyre kushteve, nga njëra anë do të ndihmojë për ta bërë BE-në më homogjene në të dy fushat si ekonomikisht ashtu edhe politikisht, duke ulur kostot e vendim-marrjes, dhe nga ana tjetër do të mundësojë që shtetet të krijojnë më shumë vendimmarrje në mënyrë që të vendosin ligje dhe institucionet e tyre të jenë më të qëndrueshme dhe demokratike.

Modeli European në kuadër të një qeverisjes së mirë Europeanizuese dhe mekanizmat e saj

Europeanizimi nuk është një proces që mbaron jashtë kufijve të Bashkimit European, nëpërmjet kushtëzimeve, socializimit, funksionalitetit dhe implementimit të efekteve të jashtme që gjeneron Bashkimi European. Çfarë është në kontekst një qeverisje e jashtme europiane? Çfarë lloj Europeanizimi BE-ja po përpiket të promovoj jashtë kufijve të saj?

Në kuadër të kësaj analize, politikanët preferojnë të kenë një mjedis ndërkombëtar që është i ngjashëm, ose është të paktën i pajtueshëm me principet dhe procedurat e brendshme. Qëllimet thelbësore dhe instrumentat europeanizuese konsistojnë në “projektimin e jashtëm të zgjidhjeve të brendshme”.

Debati i qeverisjes Europiane ose modeli European është shumëdimensional ashtu sikurse është jo-vendimtarë. BE-ja nëpërmjet qeverisjes së jashtme konsiderohet si një “pushtet” dallues i veçantë në sistemin ndërkombëtarë. Francois Duchene futi emërtimin e “pushtetit civil” duke e karakterizuar BE- në si një lloj aktori ndërkombëtar që ka kapërcyer sistemin anarkik brenda vendit nëpërmjet ndihmës së politikës ndërkombëtare.

Përdorimi i termit “Pushteti civil” në kundërvënje me “Pushtetin Militar” duke përdorur instrumentat civile të qeverisjes më pak se sa përdorimi i forcës, dhe duke civilizuar sistemin ndërkombëtar duke e transformuar atë në një sistem rregullash bazuar tek modeli qeveritare i çdo vendi. Në përpjekjet që e karakterizojnë BE-në Ian Manners e emërtoi rolin specifik në çështjet botërore me termin “pushteti normative” ku impakti European në sistemin global është konceptual bazuar në “normat” e demokracisë, lirisë, paqes, të drejtat e njeriut dhe në respektimin e ligjit.

Përveç rëndësisë së diskursit mbi rolin e BE-së në botë të dy konceptet “pushteti civil” dhe “pushteti normativ” janë pjesë e zhvillimit të kushtëzimeve evropiane. Funksionimi shumë dimensional i këtyre koncepteve dhe impakti që kanë këto në procesin europeanizues i bën që të jenë jo përfundimtare. Promovimi i normave Europiane ka për qëllim të imponoj kushtëzimet politike. Gjithashtu shumë e rëndësishme është që Bashkimi European ka pësuar ndryshimet e saj ndër vite sikurse edhe kundrejt shteteve dhe rajoneve. Prandaj, nuk mund të themi se ka një model të vetëm të qeverisjes europiane. Në kuadër të kësaj analize empirike analiza fokusohet tek mekanizmat europeanizuese që implementohen nën kushtëzimet orientuese dhe mënyrës se si ato janë efektive.

Integrimi European nëpërmjet promovimit të qeverisjes së mirë implementon një model duke krijuar kushtet e përshtatshme të shteteve që të kalojnë drejt një përfaqëse liberale në mënyrë që të prodhojnë një demokraci funksionale gjithëpërfshirëse.

Modeli european nëpërmjet mekanizmave të saj europeanizuese konsiston kryesisht në shpërndarjen e rregullave të institucioneve dhe qeverisjes së saj tek vendet aspirante. Mekanizmat direkte që BE implementon konsistojnë kryesisht në kushtëzimet e europeanizimit, prandaj nëpërmjet një table ilustruese analizojmë shkurtimisht mekanizmat e modelit të qeverisjes së mirë europiane që po shpërndan përtej kufijve të saj sikurse janë:

TABELA1. MEKANIZMAT DHE KUSHTËZIMET EUROPIANE.

	Mekanizmat Direkte (BE)	Mekanizmat Indirekt (aktorët jo anëtar të BE-së)
Arsyeja dhe Pasojat	Kushtëzimet(madhësia dhe kredibiliteti i stimujve, kostot e pajtueshmërisë)	Funksionaliteti (rëndësia e rregullave dhe centralizimi
Arsyeja dhe Përshtatshmëria	Socializim ImplementimiKoncizitet, pasiguri, legjitimitet, autoriteti i BE-së, rëndësia dhe vazhdimësia e kontakteve me BE-në.	

Kushtëzimet direkte janë ato në të cilat BE-në ka një rol proaktiv drejt një qëllimi që të shpërndaj rregullat dhe modelin e qeverisjes së saj përtej kufijve. Në të kundër mekanizmat indirekte që identifikohen nga aktorët jo anëtar të BE-së luajnë një rol aktiv në promovimin e efekteve të BE-së. Procesi Europeanizimit sipas skemës së arsyes dhe pasojave. krijon manipulim të mekanizmave që ndryshojnë koston e vendeve aspirante. Në kontranst të saj Europeanizimi sipas skemës së arsyes dhe përshtatshmërisë është një model legjitim nëpërmjet rregullave, normave dhe qeverisjes europiane.

Kushtëzimi është një mekanizëm i drejtpërdrejtë i evropianizimit, e cila është e bazuar në manipulimin e llogaritjeve kosto-përfitim të aktorëve të tjerë të BE-së. BE-ja kërkon të përhapë rregullat e saj të qeverisjes me vendosjen e tyre si kushte që aktorët e jashtëm duhet të përmbushin në mënyrë që të marrin shpërblime dhe të shmangin sanksione nga BE-ja.

Përkatesisht, sanksionet e BE-së konsistojnë në pezullimin ose ndërprerjen e marrëveshjeve të tilla. Në mënyrë tipike, BE-ja përdor kushtëzimin pozitiv mbi sanksionimin e vendeve, ajo i mban në pritje për një marrëveshje, derisa ata të plotësojnë kushtet. Funksionaliteti punon përmes ndikimit të tërthortë të BE-së në llogaritjet e kosto-përfitim të aktorëve të jashtëm. Në kontrast me kushtëzimin, BE-ja promovon modele pro-aktive nëpërmjet qeverisjes së saj. Kjo do të thotë se aktorët e jashtëm të miratojnë dhe të ndjekin rregullat e BE-së përndryshe injorimi ose shkelja e tyre do të gjenerojë kundrejt koston

neto. Firmat që janë të interesuara të marrin pjesë në tregun e BE-së duhet të ndjekin rregullat e saj.

Sipas këtij koncepti analizohet se vendet ekonomitë, e të cilave janë të ndërlidhura fort me BE-në të bëjnë rregullat e tyre të brendshme në përputhje me ato të BE-së. Në përgjithësi, efektet e funksionimit rriten me madhësinë e tregut të BE-së dhe forcën e institucioneve.⁷

Socializimi përfshin të gjitha përpjekjet e BE-së për të përhapur qeverisjen evropiane duke bindur aktorët e jashtëm nëpërmjet ideve dhe normave të tyre. Ky është një mekanizëm i drejtpërdrejtë i evropianizimit të bazuar në logjikën e përshtatshmërisë.

Së fundmi, rezulton një rezonancë e lartë e qeverisjes së BE-së nëpërmjet traditave vendase, normave dhe praktikave duke ofruar kushte të favorshme për socializimin efektive.⁸

Implementimi punon në mënyrë të ngjashme, por pa një rol pro-aktiv të BE-së. Përkundrazi, BE-ja shërben si një model qeverisjes, nëpërmjet të cilave aktorët jashtëm maten. Aktorët jo-anëtare implementojnë BE-në, sepse ata i njohin rregullat dhe politikat e BE-së si zgjidhje të përshtatshme për problemet e brendshme të tyre.

Konkluzione

Modeli i qeverisjes së mire dhe mekanizmat evropianizuese për vendet candidate është kryesisht nëpërmjet kushtëzimit. Aktivitetet kryesore të BE-së konsistojnë në vendosjen e kushteve për anëtarësim, si dhe monitorimin e progresit të kandidatëve në përputhje, me rrethanat.

Në sistemin ndërkombëtar shtetet janë të pasigurt dhe kanë më shumë gjasa për të kërkuar dhe të implementojnë modele. Ata kanë më shumë gjasa për të zgjedhur BE-në si modelin e tyre nëse ata identifikohen me BE-në, janë në kontakt të ngushtë me BE-në, dhe për të gjetur qeverisjen e BE-së për të predikuar besimet dhe praktikat e tyre.

Kushtet, për kushtëzimin efektiv janë përgjithësisht të favorshme në marrëdhëniet e vendeve candidate të BE-së. Anëtarësimi është shpërblimi më i madh i BE-së që mund t'i ofrojë vendeve joanëtare. BE-ja gjithashtu ka qenë mjaft i qëndrueshëm në zbatimin e kushteve të saj, dhe kandidatët do të presin që të pranohet vetëm pas përmbushjes së kërkesave evropiane.

BE-ja është bërë një lojtar i madh në qeverisjen globale. Qeverisja e saj e jashtme konsiston në eksportimin e rregullave dhe mënyrat e qeverisjes së saj të brendshme për vendet jo-anëtare dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, duke kontribuar për evropianizimin e qeverisjes përtej kufijve të BE-së. Ky artikull është përpjekur të demonstrojë se konceptet “pushtet civil” dhe “pushtet normative”, që vazhdon të formojë diskutimet e marrëdhënive të jashtme të BE-së është shumë specifike për të kapur mënyrat e ndryshme në të cilat BE-ja ushtron qeverisjen e jashtme - dhe efektivitetin e saj të ndryshëm. Në të kundërt, ajo është përpjekur të tregojë se si mekanizmat dhe kushtet e evropianizimit të ndryshojnë nëpërmjet “rrethëve koncentrikë” të qeverisjes së jashtme të BE-së.

Bibliografia

- Alter, K.J. & Meunier-Aitsahalia, S. (1994). Judicial politics in the European community: European integration and the pathbreaking Cassis de Dijon decision. *Comparative Political Studies* 26: 535–561.
- Benz, A. & Goetz, K.H. (eds) (1996). *A new German public sector? Reform, adaptation and stability*. Aldershot: Dartmouth
- Börzel, T.A. (1999). The domestic impact of Europe: Institutional adaptation in Germany and Spain. PhD thesis, European University Institute, Florence.
- Caporaso, J., Coëles, M.G. & Risse, T. (eds) (2001). *Europeanization and domestic change*. Ithaca, NY: Cornell University Press.
- Börzel T.A., Yasemin Pamuk, Andreas Stahn “Good Governance in the European Union”, 2010
- Checkel, J.T. (1998). Social construction, institutional analysis and the study of European integration. Paper presented at the Workshop on Institutional Analysis of European Integration of the European Consortium for Political Research, Eärëick, March 23–28.
- Cowles, M.G. & Risse, T. (2001). Europeanization and domestic change: Conclusions. in J. Caporaso, M.G. Coëles & T. Risse (eds.), *Europeanization and domestic change*. Ithaca, NY: Cornell University Press.
- Dimitrova, A. & Steunenberg, B. (2000). The search for convergence of national policies in the European Union: An impossible quest? *European Union Politics* 1(2): 201–226.
- Douillet, A.-C. & Lehmkuhl, D. (2001). Strengthening opposition and pushing reform: Europe’s differential impact on French transport reform. in A. Héritier et al., *Differential Europe: New opportunities and restrictions for member-state policies*. Lanham, MD: Rowman & Littlefield.
- Schimmelfennig, F./Engert, S./Knobel, H.: International Socialization in Europe. Regional Organizations, Political Conditionality, and Democratic Change, Basingstoke, 2006. See also Freyburg, T./Richter, S.: National Identity Matters: the Limited Impact of EU Political Conditionality in the Eastern Balkans, in: *Journal of European Public Policy* 17/2, 263–281.
- Schimmelfennig, F./Sedelmeier, U.: Conclusions: The Impact of the EU on the Accession Countries (Cowles & RISSE 2001). (Taylor 1983) (Scharpf 1999) (Kitschelt 1986) (Hammerman dhe Schëeickert, 2005, Nëntor).
- Duchene, F.: Europe’s role in World Peace, in: Mayne, R. (ed.): *Europe Tomorrow: Sixteen Europeans Look Ahead*, London, 1972, 32–47
- Schimmelfennig, F./Sedelmeier, U., op. cit., 12–16.
- Checkel, J.: Why Comply? Social Learning and European Identity Change, in: *International Organization* 55/3, 2001, 553–588, pp. 562–563; see also Risse, T.: “Let’s Argue!” Communicative Action in World Politics, in: *International Organization* 54/1, 2000, 1–39, p. 19.

PËRDORIMI I STATISTIKAVE s^2 DHE c NË PROCESIN E KONTROLLIT TË CILËSISË SË PRODHIMIT

TEUTA XHINDI

UET, Fakulteti Ekonomik, Profili Statistikë

ABSTRAKT

Ka mjaft raste në praktikë në të cilat jemi të interesuar për të përmirësuar cilësinë e një produkti. Kjo mund të realizohet duke ndryshuar disa nga faktorët e prodhimit. Cilësia e produktit mund të vlerësohet me ndihmën e statistikave s^2 (varianca e zgjedhjes), c (koeficienti i variacionit të zgjedhjes) etj.

Për konkretizim, shohim rastin kur statistika e zgjedhur është varianca e zgjedhjes s^2 si dhe koeficienti i variacionit të zgjedhjes c , në rastin kur zgjedhja është bërë nga popullimi normal.

Nëse ka qenë apo jo efektive masa që kemi marrë për përmirësimin e cilësisë, mund të sqarohet kështu:

Bazuar në rezultatet e provave para dhe pas masës së marrë, gjejmë dy vlera të statistikës s^2 ose c . Më pas, nëpërmjet kontrollit të hipotezave statistikore, përcaktojmë me një probabilitet të caktuar, nëse ndryshimet në një produkt (p.sh. tek betoni) kanë qenë të rastit apo thelbësore.

Kriteri ndërtohet duke u bazuar në shpërndarjen e statistikave s^2 dhe c .

Dimë se kur $X^i = (x_1, x_2, \dots, x_n)$ është zgjedhje nga bashkësia normale $N(\mu, \sigma^2)$, statistika s^2 ka shpërndarje asimptotikisht normale, me parametra:

$s^2 = 1/(n-1) \cdot \sum_{i=1}^n [(x_i - \bar{x})^2] \xrightarrow{(n \rightarrow \infty)} N(\sigma^2; (2 \cdot \sigma^4)/(n-1))$ dhe statistika c ka shpërndarje asimptotikisht normale, me parametra: $c = s/\bar{x} \xrightarrow{(n \rightarrow \infty)} N(\gamma; \gamma^2/2(n-1) \cdot (1+2 \cdot \gamma^2))$

Statistikat s^2 dhe c i studiojmë në dy popullime: në bashkësinë e vlerave të tyre para se të merren masat për përmirësimin e cilësisë së produktit dhe pas ndryshimeve të faktorëve.

Ndërtohen kriteret T_{s^2} dhe T_c me anë të të cilave shihet nëse faktorët e ndryshuar kanë ndikuar në ndryshimin e statistikave s^2 dhe c . Këto kritere përdoren për zgjedhje me vëllime të mëdha dhe kur tipari sasior X i bashkësisë së përgjithshme ka ligj normal ose asimptotikisht normal.

Fjalë kyç: Statistikë, koeficienti i variacionit, shpërndarje probabilitare asimptotike etj.

Hyrje

Të realizosh një produkt me cilësi do të thotë: të prodhosh duke respektuar specifikime dhe nivele të tolerancës të përcaktuara në bazë të pritshmërive dhe preferencave të klientëve që mund të jenë konsumatorët finalë ose kompani në rastin e produkteve industriale. Në një kuptim të gjerë, quhet cilësi e një produkti aftësia e tij për t'u përdorur për qëllimin për të cilin është krijuar ose aftësia e produktit që të ketë vetitë e garantuara nga prodhuesi për të kënaqur kërkesat e tregut.

Për të prodhuar produkte të një cilësie të lartë është e nevojshme të njohësh dëshirat dhe kërkesat e klientëve; kjo është detyrë e departamentit të marketingut të një kompanie. Në vijim, është e nevojshme t'i përkthesh kërkesa të tilla në një projekt operativ, derisa të arrihet në paraqitjen e plotë inxhinierike të procesit të prodhimit që do të finalizohet me prodhimin fizik të produktit. Në fund, realizohet shpërndarja e produktit që siguron dorëzimin e produktit te klienti. Në këto kushte, të prodhosh me cilësi të lartë do të thotë të përmirësosh të gjitha proceset që kontribuojnë në prodhimin e produkteve ose shërbimeve. Dinamika e tregut nënkupton një kontroll të vazhdueshëm dhe përshtatshmëri të nivelit të cilësisë së produktit. Në këtë mënyrë lind nevoja e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë që kërkon përfshirjen e të gjithë proceseve brenda kompanisë. Në këtë sens strategjia e cilësisë totale konsiderohet si një instrument për të garantuar mbijetesën dhe suksesin afatgjatë të kompanisë. Kërkesat e tregut nuk janë statike, ato janë të lidhura me vetë nivelin e cilësisë. Në këtë kuadër, është i justifikuar përdorimi i metodave të drejtpërdrejta të Kontrollit Statistikor të Procesit si mjete të vlefshme në mbështetje të veprimtarisë së vendimmarrjes në çdo nivel organizativ për arritjen e cilësisë. Në paraqitjen e metodave statistikore për kontrollin e cilësisë do të përqendrohemi në procesin e prodhimit si dhe në vetë produktin/shërbimin që del nga ky proces.

Çfarë është kontrolli statistikor i procesit?

Është pranuar se kontrolli statistikor i procesit është një metodologji që referuar një aktiviteti të caktuar, operacioni, faze ose procesi që përsëritet, përdor teknikat statistikore me qëllim analizimin dhe verifikimin e kushteve që përcaktojnë ndryshueshmërinë e objektit që analizohet. Në mënyrë të përmbledhur, bazuar në përkufizimin e dhënë nga Juran (Joseph M. Juran, 1904-2008, inxhinier dhe konsulent menaxhimi), mund të përcaktojmë kontrollin statistikor të procesit si “aplikim i teknikave statistikore për të kuptuar dhe analizuar ndryshueshmërinë e një procesi”.

Në këtë punim i jam referuar materialit të betonit dhe si tipar i cilësisë i jam referuar homogjenitetit të tij (rezistenca në shtypje duhet të jetë e njëjtë në të gjithë strukturën). Të dhënat e përdorura janë marrë nga kompania Ferro-Beton për klasën 50Mpa. Kjo klasë është produkt i një recepture të caktuar e cila siguron proporcione të caktuara të përbërësve të betonit. Është eksperimentuar një recepture e re me proporcione të reja të përbërësve për synime të caktuara.

Nëpërmjet kriterëve të gjetura më poshtë kontrollon nëse zbatimi në proces teknologjik i recepturës së re sjell ndryshime të qenësishme në homogjenitetin e betoneve të prodhuara.

Kriteret ndërtohen duke përdorur statistikën s^2 (varianca e zgjedhjes) dhe c (koeficienti i variacionit të zgjedhjes).

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Ky punim ka për qëllim ndërtimin e kriterëve me ndihmën e statistikave s^2 (varianca e zgjedhjes) dhe c (koeficienti i variacionit të zgjedhjes) për të hetuar nëse zbatimi i një recepture të re për prodhimin e betonit ka sjellë apo jo ndryshime të rëndësishme në homogjenitetin e tij.


Theksoj që, kriteret e ndërtuara përdoren për zgjedhje me vëllime të mëdha dhe kur tipari sasior X i bashkësisë së përgjithshme ka ligj normal ose asimptotikisht normal (në rastin tonë, Rezistenca në Shtypje, e parë si ndryshore rasti X , ka shpërndarje normale).

Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Pyetja Kërkimore: A mund të ndërtohet kriteri për të kontrolluar nëse ka diferenca të rëndësishme në homogjenitetin e një popullimi para dhe pas përdorimit të një recepture të re me një probabilitet të caktuar? Hipoteza: Me ndihmën e statistikave s^2 dhe c ndërtohen kriteret T_{s^2} dhe T_c me anë të të cilave shihet nëse faktorët e ndryshuar kanë ndikuar në ndryshimin e statistikave s^2 dhe c . Këto statistika shërbejnë për të vlerësuar cilësinë e produktit (në rastin tonë: homogjenitetin e betonit).

Analizë, interpretim të dhënash

Rezistenca në shtypje, e parë si ndryshore rasti X , ka shpërndarje normale siç tregohet në figurën në faqen 325. Sipërfaqja nën vijë ndërmjet dy vlerave të X na jep probabilitetin që një rezultat të bjerë ndërmjet këtyre vlerave. Termi “bisht” përdoret për të karakterizuar sipërfaqen nën vijë ndërmjet një vlere të X (pra të një vlere të rezistencës në shtypje) dhe vlerave me denduri pothuajse zero. Në rastin e rezistencës në shtypje konsiderojmë “bishtin e poshtëm” që do të thotë sipërfaqja prej një vlere çfarëdo të X dhe gjithë vlerave më të vogla se ajo.



Rezistenca karakteristike e betonit është numri që tregon se: nëse do të kryheshin të gjitha provat e mundshme, 5% e rezultateve do të bien në zonën e poshtme që fillon nga vlera 1.64σ poshtë vlerës së rezistencës mesatare. Mirëpo rezistenca mesatare nuk mund të njihet derisa betoni të jetë prodhuar dhe testuar dhe kështu rezistenca mesatare zakonisht caktohet në vlera më të mëdha për të pasur kujdes që betoni të arrijë të paktën rezistencën e llogaritur karakteristike. Rezistenca mesatare jepet prej ekuacionit:

$$R_m = R_{ck} + k \cdot \sigma$$

ku: R_m është rezistenca mesatare, R_{ck} është rezistenca karakteristike në shtypje, σ është devijimi standard për popullatën, k është konstante, $k \cdot \sigma$ është marzhi i gabimit.

Një vlerë e rezistencës R_m poshtë rezistencës karakteristike nuk konsiderohet dështim sepse statistikiht 5% e rezultateve pritet dhe pranohet të bien poshtë kësaj vlere. Megjithatë, për arsye të sigurisë së strukturës, në standardet EN 206-1, për klasat që rezistencën në shtypje e kanë më të vogël ose të barabartë me $C_{(50/60)}$, përcaktohet një minimum i rezistencës së kërkuar për rezultatet individuale $R_{ci} = R_{ck} - 4$ (N/mm^2). Ndërsa, për klasat që rezistencën në shtypje e kanë më të madhe ose të barabartë me $C_{(55/67)}$, ky minimum duhet të jetë $R_{ci} \geq 0.9 R_{ck}$. Çdo sasi betoni që nuk plotëson këto kushte konsiderohet jo e rregullt.

Dimë se kur $X' = (x_1, x_2, \dots, x_n)$ është zgjedhje nga bashkësia normale $N(\mu, \sigma^2)$, statistika s^2 ka shpërndarje asimptotikiht normale, me parametra:

$$s^2 \xrightarrow{(n \rightarrow \infty)} N\left(\frac{\sigma^2}{2}, \frac{2 \cdot \sigma^4}{(n-1)}\right)$$

po ashtu, dhe statistika c ka shpërndarje asimptotikiht normale, me parametra:

$$c \xrightarrow{(n \rightarrow \infty)} N\left(\frac{\gamma^2}{2(n-1)}, \frac{1+2\gamma^2}{n-1}\right)$$

ku,

- koeficienti i variacionit të popullimit nga është bërë zgjedhja

n - numri i elementeve të zgjedhjes

μ - mesatarja e popullimit

σ^2 - varianca e

popullimit

σ - devijimi standard i popullimit

\bar{x} - mesatarja e zgjedhjes

x_i janë vlerat individuale të karakteristikës që është marrë në shqyrtim (në rastin tonë, të rezistencës në shtypje të betonit)

Statistikat s^2 dhe c i studiojmë në dy popullime: në bashkësinë e vlerave të tyre para se të merren masat për përmirësimin e cilësisë së produktit dhe pas ndryshimeve të faktorëve.

Realizojmë dy zgjedhje, me vëllime përkatësisht n_1 dhe n_2 nga këto dy popullime.

Vlerësimet e gjetura s_1^2 dhe s_2^2 i konsiderojmë si vlera të dy madhësive të rastit s_1^2 dhe s_2^2 , të pavarura, të tilla që:

$$s_i^2 \xrightarrow{(n \rightarrow \infty)} N(\mu_i; \sigma_i^2), \forall i=1,2$$

Në këto kushte, për të parë nëse kanë ndikuar faktorët e ndryshuar në ndryshimin e vlerave të statistikës s^2 , mund të bëjmë kontrollin e hipotezave të mëposhtme statistikore:

$H_0: \mu_1 = \mu_2$, me hipotezë alternative:

$H_a: \mu_1 \neq \mu_2$, me nivel rëndësie α të dhënë.

$$T_{s^2} = \frac{|s_1^2 - s_2^2|}{\sigma \sqrt{(1/n_1 + 1/n_2)}} \stackrel{(n \rightarrow \infty @ H_0)}{\rightarrow} N(0,1)$$

dhe zona kritike e kriterit T_{s^2} është zona për të cilat $|T_{s^2}| > z_\alpha$, ku z_α përcaktohet nga ekuacioni $2\Phi(z_\alpha) - 1 = 1 - \alpha$.

Statistika T_{s^2} merret si kriter për kontrollin e hipotezës H_0 .

Në rastin kur σ_i^2 ($i=1,2$) nuk njihen, por supozohet se $\sigma_i^2 = \sigma^2$, dihet se statistika T_{s^2} ka shpërndarje studentit me $n_1 + n_2 - 2$ shkallë lirie, pra:

$$T_{s^2} = \frac{|s_1^2 - s_2^2|}{\sqrt{((n_1-1) \cdot s_1^2 + (n_2-1) \cdot s_2^2) \cdot \frac{1}{(n_1+n_2-2)}}} \stackrel{(H_0)}{\sim} t_{(n_1+n_2-2)} \quad (1)$$

dhe zona kritike e kriterit përcaktohet e tillë që:

$$P(|T_{s^2}| > t_{(1-\alpha/2); n_1+n_2-2}) = 1 - \alpha/2$$

Duke ditur se, varianca empirike e statistikës s^2 është $(2 \cdot s_i^4)/(n_i - 1)$, $\forall i=1,2$, duke zëvendësuar në barazimin (1), nxjerrim që:

$$T_{s^2} = \frac{|s_1^2 - s_2^2|}{\sqrt{(2 \cdot s_1^4 + 2 \cdot s_2^4) \cdot \frac{1}{(n_1+n_2-2)}}} \stackrel{(2)}{\sim} t_{(n_1+n_2-2)}$$

Kryejmë të njëjtën procedurë edhe për statistikën c .

Vlerësimet e gjetura c_1 dhe c_2 i konsiderojmë si vlera të dy madhësive të rastit c_1 dhe c_2 , të pavarura, të tilla që:

$$c_i \stackrel{(n \rightarrow \infty)}{\rightarrow} N(\mu_i, \sigma_i^2), \forall i=1,2$$

Edhe këtu, për të parë nëse kanë ndikuar faktorët e ndryshuar në ndryshimin e vlerave të statistikës c , mund të bëjmë

kontrollin e hipotezave të mëposhtme statistikore:

$H_0: \mu_1 = \mu_2$, me hipotezë alternative:

$H_a: \mu_1 \neq \mu_2$, me nivel rëndësie α të dhënë.

Në rastin kur $\sigma_i^2 = \sigma^2$ ($i=1,2$) njihen, dihet se kriteri T_c :

$$T_c = \frac{|c_1 - c_2|}{\sigma \sqrt{(1/n_1 + 1/n_2)}} \stackrel{(n \rightarrow \infty @ H_0)}{\rightarrow} N(0,1) \quad (3)$$

dhe zona kritike e kriterit T_c është zona për të cilat $|T_c| > z_\alpha$, ku z_α përcaktohet nga ekuacioni $2\Phi(z_\alpha) - 1 = 1 - \alpha$.

Statistika T_c merret si kriter për kontrollin e hipotezës H_0 .

Në rastin kur σ_i^2 ($i=1,2$) nuk njihen, por supozohet se $\sigma_i^2 = \sigma^2$, dihet se statistika T_c ka shpërndarje studentit me $n_1 + n_2 - 2$ shkallë lirie, pra:

$$T_c = \frac{|c_1 - c_2|}{\sqrt{((n_1-1) \cdot s_{(c_1)}^2 + (n_2-1) \cdot s_{(c_2)}^2) \cdot \frac{1}{(n_1+n_2-2)}}} \stackrel{(H_0)}{\sim} t_{(n_1+n_2-2)} \quad (4)$$

dhe zona kritike e kriterit përcaktohet e tillë që:

$$P(|T_c| > t_{(1-\alpha/2); n_1+n_2-2}) = 1 - \alpha/2$$

Duke ditur se, varianca empirike e statistikës c është $\frac{1}{2} \frac{c_i^2}{(n_i-1)} (1 + 2 \frac{c_i^2}{\sigma^2})$, $\forall i=1,2$, duke zëvendësuar

në barazimin (4), nxjerrim që:

$$T_c = \frac{|c_1 - c_2|}{\sqrt{\left(\frac{c_1^2}{2} (1 + 2 \frac{c_1^2}{\sigma^2}) + \frac{c_2^2}{2} (1 + 2 \frac{c_2^2}{\sigma^2}) \right) \cdot \frac{1}{(n_1+n_2-2)}}} \stackrel{(5)}{\sim} t_{(n_1+n_2-2)}$$

Theksojmë se kriteret e dhëna $T_{(s^2)}$ dhe T_c me anë të të cilave shihet nëse faktorët e ndryshuar kanë ndikuar në ndryshimin e statistikave s^2 dhe c , përdoren për zgjedhje me vëllime të mëdha dhe kur tipari sasior X i bashkësisë së

"Transformimi i Madh: 25 vjet përvoja shqiptare e tranzicionit dhe demokratizimit"

përgjithshme ka ligj normal ose asimptotikisht normal.

I referohemi të dhënave të marra nga kompania Ferro-Beton për klasën 50Mpa. Kjo klasë është produkt i një recepture të caktuar e cila siguron proporcione të caktuara të përbërësve të betonit. Është eksperimentuar një recepture e re me proporcione të reja të përbërësve për synime të caktuara. Detyra jonë është të kontrollojmë nëse zbatimi në proces teknologjik i këtyre dy recepturave sjell ndryshime të qenësishme në homogjenitetin e betoneve të prodhuara.

Kontrollin po e bëjmë duke përdorur të dy kriteret e mësipërme dhe po krahasojmë rezultatet e dala nga këto kontrole. Nga të dhënat e siguruar, nga një zgjedhje prej $n_1=25$ mostrash para eksperimentimit të recepturës së re rezultoi vlera e variancës së zgjedhjes e barabartë me $s_{11}^2 = 2.8\text{Mpa}^2$. Pas eksperimentimit, nga një zgjedhje prej $n_2 = 21$ mostrash rezultoi vlera e variancës së zgjedhjes e barabartë me $s_{22}^2 = 3.13\text{Mpa}^2$

Prej (2), vlera T_{s^2} e kriterit është:

$$T_{s^2} = \frac{|s_{11}^2 - s_{22}^2|}{\sqrt{(2 \cdot s_{11}^4 + 2 \cdot s_{22}^4) \cdot \frac{(n_1 \cdot n_2 \cdot (n_1 + n_2 - 2))}{(n_1 + n_2)}}} =$$

$$\frac{|2.8 - 3.13|}{\sqrt{(2 \cdot (2.8)^2 + 2 \cdot (3.13)^2)}} =$$

$$\frac{0.33}{\sqrt{(2 \cdot (2.8)^2 + 2 \cdot (3.13)^2)}} =$$

$$1.245.$$

Nga tabela studenti, për $\alpha = 5\%$, $t_{(1-\alpha/2; n_1+n_2-2)} = 2.015$. Meqë $T_{s^2} < t$, konkludojmë se eksperimentimi i recepturës së re nuk ka të dhëna që të ketë sjellë ndryshime të qenësishme në homogjenitetin e betoneve të prodhuara.

Nëse i referohemi vlerave të koeficientit të variacionit, nga zgjedhja prej $n_1=25$ mostrash para eksperimentimit të recepturës së re rezultoi vlera e koeficientit të variacionit të zgjedhjes e barabartë me $c_1 = 0.031$. Pas eksperimentimit, nga zgjedhja prej $n_2 = 21$ mostrash rezultoi vlera e koeficientit të variacionit të zgjedhjes e barabartë me $c_2 = 0.03089$.

Prej (5), vlera T_c e kriterit është:

$$T_c = \frac{|0.031 - 0.03089|}{\sqrt{\frac{(1 + 2 \cdot (0.031)^2)}{2} + \frac{(1 + 2 \cdot (0.03089)^2)}{2}} \cdot \frac{(n_1 \cdot n_2 \cdot (n_1 + n_2 - 2))}{(n_1 + n_2)}} =$$

$$T_c = 0.079582$$

Nga tabela studenti, për $\alpha = 5\%$, $t_{(1-\alpha/2; n_1+n_2-2)} = 2.015$. Edhe në këtë rast, meqë $T_c < t$, konkludojmë se eksperimentimi i recepturës së re nuk ka të dhëna që të ketë sjellë ndryshime të qenësishme në homogjenitetin e betoneve të prodhuara.

Duke krahasuar të dy kriteret, shohim se përfundimet janë të njëjta.

Konkluzione/ Rekomandime

Me ndihmën e shpërndarjeve asimptotike të statistikave c dhe s^2 , u arrit të ndërtohen kriteret e mëposhtme:

$$T(s^2) = \frac{s \omega_1^2 - s \omega_2^2}{\sqrt{(2s \omega_1^4 + 2s \omega_2^4) \cdot \sqrt{((n_1 \cdot n_2 \cdot (n_1 + n_2 - 2)) / (n_1 + n_2))}}}$$

$$T_c = \frac{c \omega_1 - c \omega_2}{\sqrt{((c \omega_1^2 (1 + 2(c \omega_1^2)) / 2 + ((c \omega_2^2 (1 + 2(c \omega_2^2)) / 2) \cdot \sqrt{((n_1 \cdot n_2 \cdot (n_1 + n_2 - 2)) / (n_1 + n_2))}})}$$

Ditët e Studimeve Shqiptare / 2015

Me ndihmën e këtyre kriterëve, mund të vlerësojmë nëse zbatimi i një recepture të re ka sjellë ndryshime të rëndësishme në homogjenitetin e betoneve të prodhuar.

Në këtë mënyrë realizohet kontrolli i cilësisë dhe konkludohet për vijimësinë apo jo të procesit të prodhimit.

Bibliografia

Katz M., (1963), "The probability in the tail of a distribution", Ann. Math. Statist. 34, 312–318.

Leka Sh, (2004), "Teoria e Probabiliteteve dhe Statistika Matematike", Tiranë.

Leka Sh, (2011), "Një kriter për kontrollin e koeficientit të variacionit të zgjedhjes të nxjerrë nga bashkësia e përgjithshme normale, "Studime të avancuara në inxhinierinë matematike, fizike dhe kimike, fq 15, Tiranë.

Miller G., (1991), "Asymptotic test statistics for coefficients of variation", Communications in Statistics - Theory and Methods, Volume 20, Issue 10, fq 3351-3363.

Powell L., (2005), "Elements of Asymptotic Theory", Department of Economics, University of California,

Berkeley. <http://www.statsoft.com/Textbook/Quality-Control-Charts> <http://www.betonopus.hu/some/acceptance.pdf>

TESTIME, STUDIME DHE RAPORTE TË “RRUMBULLAKOSUR” NUK E SHËROJNË ARSIMIN, VETËM SE I ZGJATIN AGONINË

PROF. ASOC. DR. HYSEN BINJAKU

ABSTRAKT

“Nxënësit shqiptarë nën nivelin mesatar” është konkluzion i nxjerrë nga testimet ndërkombëtare dhe i pranuar edhe nga piramida arsimore në vend. Duke pranuar këtë realitet, gjithë sistemi arsimor ka filluar të mendojë e veprë për ndryshimin e gjendjes. Në lëvizje është vënë edhe Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), strukturë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, hallkë e rëndësishme e piramidës arsimore. Në Shkurt të vitit 2015, AKP ka publikuar një Raport lidhur me një studim të bërë prej sajë në Maj 2014. Raporti jep të dhëna në nivel kombëtar për arritjet e nxënësve në shkollat publike dhe private të arsimit të detyruar. Gjithashtu, në këtë raport jepen të dhëna për arritjet e nxënësve sipas përkatësisë gjinore: meshkuj-femra; vendodhjes: fshat-qytet; pronësisë: private-publike; ciklit të shkollës: 9-vjeçare -MB – CU si dhe për karakteristikat e testeve të provimit në tërësi apo kërkesave të testeve në veçanti. Media e përcolli si lajm këtë raport duke dhënë mjaft shifra e konkluzione nga gjetjet dhe i shoqëroi ato me komente të shumta. E përbashkëta e komenteve ka qenë: “Nxënësit e 9-vjeçares në Shqipëri rezultojnë dobët deri në limitet e analfabetizmit në lëndët Gjuhë Shqipe, Matematikë dhe Dituri Natyre”. Në këtë artikull nuk do të ndalem në analizën e kësaj gjendje as edhe në “gjetjen e fajtorëve”. Gjetjet e Raportit publik të AKP do të përpiqem t’i shoh në një këndvështrim disi më ndryshe. Raporti “Vlerësimi Kombëtar për lëndët: Gjuhë Shqipe, Matematikë, Dituri Natyre, klasa 3 dhe 5”, sipas vetë AKP, synon: të paraqesë në mënyrë përshkuese dhe statistikore arritjet e nxënësve në klasën e 3-të dhe të 5-të, në lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre; të japë informacion për autoritet arsimore dhe publikun e gjerë, për rezultatet e nxënësve në këto klasa, për periudhën shtator-prill 2013 -2014. Pikërisht, ky do të jetë këndvështrimi im, të cilin e shtroj në formën e kësaj pyetje: A ka arritur Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) që nëpërmjet këtij Studimi dhe Raporti Publik të realizojë synimet e mësipërme?

Fjalë kyç: Raport publik, testim, kalueshmëri, notë, notë mesatare, pikë, pikë mesatare, program, tabela, arritje e nxënësve, specialist, mësues.

Hyrje

Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) ka bërë publik Raportin: Vlerësimi Kombëtar për lëndët: Gjuhë Shqipe, Matematikë, Dituri Natyre, klasa 3 dhe 5.

Raporti jep të dhëna në nivel kombëtar për arritjet e nxënësve në shkollat publike dhe private të arsimit të detyruar. Gjithashtu, në këtë raport jepen të dhëna për arritjet e nxënësve sipas përkatësisë gjinore, urbanizimit, pronësisë, ciklit të shkollës si dhe për karakteristikat e testeve të provimit në tërësi apo kërkesave të testeve në veçanti.

Të dhënat janë paraqitur në mënyrë tabelore e grafike, të shoqëruara me shpjegimet përkatëse, duke i mundësuar specialistëve të interesuar dhe publikut të gjerë të nxjerrin në pah ndryshimet dhe ngjashmëritë e arritjeve midis grupimeve të ndryshme të popullatës së testuar.

Në hyrje të Raportit [Raporti publik faqe 2], thuhet: Raporti publik "Vlerësimi kombëtar i arritjeve të nxënësve të klasës së 3-të dhe të 5-të, të arsimit të detyruar, viti shkollor 2013-2014, në lëndët matematikë, gjuhë shqipe dhe dituri natyre", synon:

të paraqesë në mënyrë përshkuese dhe statistikore arritjet e nxënësve në klasën e 3-të dhe të 5-të, në lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre.

të japë informacion për autoritet arsimore dhe publikun e gjerë, për rezultatet e nxënësve në këto klasa, për periudhën shtator-prill 2013 -2014.

Pa dashur të mohoj punën e bërë nga të gjithë ata që janë angazhuar në këtë punë, sidomos me organizimin dhe zhvillimin e testimit, raportin e gjej me disa gabime, të cilat janë sa metodike aq edhe parimore. Për të bërë prezent ato që unë i konsideroj gabime, do të më duhet që herë pas here të paraqes apo citoj atë çka thuhet në raport (citimet nga raporti do të jenë në shkrim italic).

Raporti është i ndarë në tri pjesë:

Pjesa I : Njohuritë e vlerësuara; Arritjet; Gjetjet; Përfundimet; Rekomandimet

Pjesa II – Raporti teknik Klasa III

Pjesa III – Raporti teknik Klasa V

Shtojca : Testi i klasës III ; Testi i klasës V

Në Pjesa I, pika 2, Arritjet e nxënësve (testi i kombinuar) [Raporti publik faqe 6, 7] jepen disa tabela si dhe konkluzione të quajtura "Disa nga arritjet në nivel kombëtar".

TABELA (REZULTATET TESTI I KOMBINUAR) KLASA 3

	Niveli 0	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5	Niveli 6
Pikë	0-10	11-17	18-24	25-31	32-38	39-45	46-50
Nota	4	5	6	7	8	9	10
nr.nx	131	142	212	283	107	97	90
%	12.34	13.37	19.96	26.65	10.08	9.13	8.47

Disa nga arritjet në nivel kombëtar:

Kalueshmëria: 87.66%

Nxënësit e qytetit kanë arritje thujse të njëjta me ata të fshatit.

Vajzat kanë arritje pak më të larta se djemtë.

Shkollat private kanë arritje më të larta se ato publike.

TABELA (REZULTATET TESTI I KOMBINUAR) KLASA 5

	Niveli 0	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5	Niveli 6
Pikë	0-10	11-17	18-24	25-31	32-38	39-45	46-50
Nota	4	5	6	7	8	9	10
nr.nx	172	141	172	262	247	124	173
%	13.32	10.92	13.32	20.29	19.13	9.60	13.40

Disa nga arritjet në nivel kombëtar:

Kalueshmëria: 86.68%

Nxënësit e qytetit kanë arritje thuajse të njëjta me ata të fshatit.

Vajzat kanë arritje pak më të larta se djemtë.

Shkollat private kanë arritje më të larta se ato publiket.

Tabela (rezultatet testi i kombinuar) Klasa 3 dhe Tabela (rezultatet testi i kombinuar) Klasa 5 janë ndërtuar bazuar në tabelat përkatëse për secilën nga lëndët: Gjuhë Shqipe, Matematikë dhe Dituri Natyre. Këto tabela gjenden në Pjesën II dhe të Raportit publik [Raporti publik faqe 16, 23, 28, 34, 41, 46]. Meqenëse gjatë analizës do të më duhen rezultatet e atyre tabelave, po i ri sjell ashtu sikundër janë ndërtuar nga vetë hartuesit e raportit publik.

TABELA (REZULTATET GJUHË SHQIPE) KLASA 3

Niveli	Niveli 0 (Dobët)	Niveli 1 (Mjaftueshëm)	Niveli 2 (Mirë)	Niveli 3 (Sh. Miirë)
Pikë	0-5	6-11	12-16	17-20
Nr.nx	153	417	268	224
%	14.40	39.26	25.23	21.09

TABELA (REZULTATET GJUHË SHQIPE) KLASA 5

Niveli	Niveli 0 (Dobët)	Niveli 1 (Mjaftueshëm)	Niveli 2 (Mirë)	Niveli 3 (Sh. Miirë)
Pikë	0-5	6-11	12-16	17-20
Nr.nx	168	280	449	394
%	13.01	21.68	34.77	30.51

Niveli 0: bëjnë pjesë nxënësit që nuk kanë arritje të mjaftueshme për t'u quajtur kalues

TABELA (REZULTATET MATEMATIKË) KLASA 3

Pikë	0-5	6-8	9-11	12-14	15-16	17-18	19-20
Nota	4	5	6	7	8	9	10
nr.nx	123	244	215	124	131	89	136

Kalueshmëria 88%, Nota mesatare 6.5

TABELA (REZULTATET MATEMATIKË) KLASA 5

Pikë	0-5	6-8	9-11	12-14	15-16	17-18	19-20
Nota	4	5	6	7	8	9	10
nr.nx	275	174	184	179	195	188	96

Kalueshmëria 74.36%, Nota mesatare 5.6

TABELA (REZULTATET DITURI NATYRE) KLASA 3

Pikë	0-1	2-3	4-5	6-7	8	9	10
Nota	4	5	6	7	8	9	10
nr.nx	42	44	59	378	219	107	213

TABELA (REZULTATET DITURI NATYRE) KLASA 5

Pikë	0-1	2-3	4-5	6-7	8	9	10
Nota	4	5	6	7	8	9	10
nr.nx	27	41	121	189	345	423	145

Si janë zbatuar standardet në nxjerrjen e rezultateve të testimit

Në raport thuhet: Për të pasur një pasqyrë më të qartë të shpërndarjes së arritjeve, u përcaktuan 6 nivele të ndryshme për testin e kombinuar, sipas shkallëzimit të mëposhtëm. Kështu, rezultatet përmbledhen sipas 6 niveleve të aftësisë, nga niveli më i ulët tek niveli më i lartë i zotësisë që kanë treguar nxënësit në test. Kjo ndarje është bërë në përputhje me sistemin e pikëzimit që përdoret shpesh tek ne për vlerësimin e nxënësit dhe për t'u bërë më e kuptueshme nga opinioni i gjerë dhe organizmat vendimmarrëse. [Raport publik faqe 6]

Flitet për 6 (gjashtë) nivele të aftësisë së nxënësve, në fakt në tabela janë 7 (shtatë) të tillë. Arsyet e një mospërputhje të tillë, më mirë se kushdo mund ta dinë vetëm ata që kanë bërë raportin, për mendimin tim ato mund të jenë dy. Ky ndryshim të jetë një lapsus i kontrollorëve dhe hartuesve të raportit të AKP dhe do të ishte rasti më pak i qortueshëm. Rasti më fatal do të ishte që Nivelin 0 (dobët) raportbërsit, (me shumë gjasa), nuk e kanë konsideruar fare si nivel aftësie. Por, po le mënjanë numrin e niveleve, dhe analizoj se si janë ndërtuar nivelet dhe ç'përfaqësojnë ato.

Përgjithësisht, kur ndërtohen tabela mbi rezultatet e testimeve apo provimeve të zakonshme, të dhënat ndahen në nivele (kryesisht sipas notave), duke respektuar disa parime të mirë përcaktuara më parë.

Së pari: parapërcaktohet cili do jetë niveli minimal i njohurive që duhet të zotërojë nxënësi për t'u konsideruar kalues. Ky nivel jepet në përqindje në raport me programin dhe pastaj "përkthehet" në pikë dhe notë. Në klasën e tretë dhe të pestë për vitin mësimor 2013-2014 (kur është bërë testimi) sistemi i vlerësimit ka qenë ai me dhjetë nota, nota minimale e kalimit është pesë.

Duke e konsideruar të mirëqenë rezultatin e tabelave të mësipërme (më poshtë këtë rezultat e vë seriozisht në diskutim) vihet re se:

Në testin e quajtur "testi i kombinuar" nxënësi vlerësohet me notën 4 (katër) kur ka marrë nga 0 (zero) deri në 10 (dhjetë) pikë nga 50 (pesëdhjetë) të mundshme, domethënë nxënësi konsiderohet kalues nëse zotëron mbi 20% të programit mësimor ($(10/50)*100\%=20\%$).

Në testin për lëndën Gjuhë Shqipe dhe Matematikë nxënësi vlerësohet me notën 4 (katër) kur ka marrë nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) pikë nga 20 (njëzetë) të mundshme, domethënë nxënësi konsiderohet kalues nëse zotëron mbi 25% të programit mësimor ($(5/20)*100\%=25\%$).

Në testin për lëndën Dituri Natyre nxënësi vlerësohet me notën 4 (katër) kur ka marrë nga 0 (zero) deri në 1 (një) pikë nga 10 (dhjetë) të mundshme, domethënë nxënësi konsiderohet kalues nëse zotëron mbi 10% të programit mësimor ($(1/10)*100\%=10\%$).

Ka probleme që nuk "shkojnë" në këtë proces vlerësimi. Pjesa e programit të lëndës, që nxënësi duhet të zotërojë për t'u konsideruar kalues, ndryshon nga lënda në lëndë. Ç' domethënë kjo?! Ka apo s'ka standarde në vlerësim?! Nëse veprohet kështu nga ata që kanë për detyrë të kontrollojnë zbatimin e standardeve, ç'mund të thuhet për mijëra mësuesit në të gjithë vendin? Gjithashtu, pjesa e programit të lëndës që nxënësi duhet të zotërojë për t'u konsideruar kalues, që shpesh konsiderohet edhe "pragu" i kalimit, është shumë-shumë pak (mbi 10%, mbi 20% apo edhe mbi 25%). Nëse kërkesa ulet kaq shumë në një testim kombëtar, që, në fund të fundit, kërkon të nxjerrë në dukje mangësitë në njohuritë e nxënësve apo të metat në procesin e mësimdhënies, me qëllimin e mirë që të rindërtohet puna në të ardhmen, ç'mund të thuhet për detyrat me shkrim apo vlerësimin me gojë që bën mësuesi i lëndës gjatë vitit mësimor, i cili, pse ta fshehim, shpesh herë dhe për mjaft arsye është në "hall" pasi i duhet apo i kërkohet që të vërë një "copë pesë"?!

Së dyti: Numri i niveleve duhet të jetë i njëjtë për secilin nga testimet e kryera dhe me të njëjtin emërtim. Nuk është vepruar kështu në Raportin publik. Në lëndën Gjuhë Shqipe, nuk ka 6 (gjashtë) nivele kaluese (siç janë në Matematikë, Dituri Natyre dhe Testi i Kombinuar) por vetëm 3 (tre) të tillë. Në Matematikë dhe Dituri Natyre nivelet, nga më i ulëti tek më i larti, shoqërohen me pikë dhe notën korresponduese. Në lëndën Gjuhë Shqipe nuk ka nota por ato janë zëvendësuar me vlerësimin Mjaftueshëm, Mirë dhe Shumë Mirë. Nuk është normale dhe serioze që në të njëjtin testim, në të njëjtin raport të përdoren dy metoda të ndryshme vlerësimi për nxënësit, kur në rregullore thuhet se vlerësimi i nxënësve të Klasës së 3-të dhe 5-të bëhet me sistemin me dhjetë nota.

Së treti: Në lëndën Gjuhë Shqipe, nga niveli në nivel ka shpërpjesëtim të paarsyeshëm të pikëve. Për nivelin Mjaftueshëm, që do të thotë nota 5 ose 6, nxënësi duhet të marrë nga 6 deri në 11 pikë, domethënë janë në dispozicion 6 (gjashtë) pikë ose 30% e programit. Për nivelin Mirë, që do të thotë nota 7 ose 8, nxënësi duhet të marrë nga 12 deri në 16 pikë, domethënë janë në dispozicion 5 (pesë) pikë ose 25% e programit. Për nivelin Shumë Mirë, që do të thotë nota 9 ose 10, nxënësi duhet të marrë nga 17 deri në 20 pikë, domethënë janë në dispozicion 4 (katër) pikë ose 20% e programit. E njëjta gjë është edhe për lëndët Matematikë dhe Dituri Natyre. Jo! Kjo nuk shkon. Ndarja në nivele pa përcaktuar kritere lë shteg për subjektivizëm, jep kalueshmëri fiktive (në të shumtën e rasteve më të lartë) dhe, më keq akoma, njohurit e nxënësve nuk vlerësohen drejt.

Në mbyllje të kësaj pike, mbi standardet dhe kriteret, po sjell edhe përfundimin e arritur në raport, në rubrikën "Faktorët që mund të kenë ndikuar në këto rezultate", ku thuhet: "Fiktiviteti në vlerësimin e nxënësve gjatë procesit mësimor; mungesa e kriterëve kombëtare të vlerësimit në shkollë, të qarta dhe të sakta, ka sjellë pështjellim në vlerësimin me notë të nxënësve" [Raport publik faqe 9].

Pra, specialistët e AKP kanë "konstatuar" mungesën e kriterëve dhe standardeve, bile pështjellime në vlerësimin me notë të nxënësve, ndërsa vetë nuk kanë bërë përpjekjen më të vogël për të punuar me standarde dhe zbatuar kritere.

Në raport bëhet fjalë për rezultate të testit të kombinuar dhe jepen këto shifra: Kalueshmëria 87.66% për Klasën 3 dhe 86.68% për Klasën 5 [Raporti publik faqe 6, 7]. Lind pyetja: Çdo të thotë “rezultatet testi i kombinuar” dhe si janë nxjerrë këto rezultate? Në “Tabela (rezultatet testi i kombinuar) Klasa 3” vëmë re se numri i nxënësve vlerësuar me notë 4 (domethënë mbetës) është 131 dhe kalueshmëria 87.66%.

Ndërkohë, nga tabelat e ndërtuara për testet sipas lëndëve kemi:

Gjuhë Shqipe:	153 nxënës mbetës, kalueshmëria 85.56%, nota mesatare nuk jepet
Matematikë:	123 nxënës mbetës, kalueshmëria 88.42%, nota mesatare 6.5
Dituri Natyre:	42 nxënës mbetës, kalueshmëria 96.04%, nota mesatare nuk jepet

Të gjithë e dimë, aq më shumë specialistët e AKP, se një nxënës konsiderohet mbetës në klasë kur ai është i tillë të paktën në një lëndë.

Në Klasën 3, numri minimal (rasti më i mirë i mundshëm) i nxënësve mbetës nga 1062 nxënësit e testuar është 153, aq sa është numri i nxënësve mbetës në lëndën Gjuhë Shqipe (për ata që kanë njohuri nga bashkësitë, kjo ndodh kur bashkimi i bashkësive të nxënësve mbetës në Gj. Sh, M, D.N. është bashkësia e nxënësve mbetës në Gj. Sh.), ngjarje që ka gjasa të ndodhë. Në këtë rast kalueshmëria do të ishte:

$$[(1062-153)/1062]*100\% = 85.56\%, \text{ pra jo } 87.56\% \text{ sa thotë Raporti publik por më e vogël.}$$

Në Klasën 3, numri maksimal (rasti më i keq i mundshëm) i nxënësve mbetës nga 1062 nxënësit e testuar do të ishte $153+123+42=318$, që merret duke menduar që nxënësit mbetës në njërin lëndë nuk janë të tillë në dy lëndët e tjera (ose siç thuhet këto bashkësi kanë si preje bashkësinë boshe), ngjarje që ka gjasa të ndodhë. Në këtë rast kalueshmëria do të ishte:

$$[(1062-318)/1062]*100\% = 70.05\%, \text{ pra jo } 87.56\% \text{ sa thotë Raporti publik por shumë më e vogël.}$$

Në këtë rast gabimi shkon deri në 17.51%.

Sipas logjikës së raport-hartuesve, del se të paktën 22 (njëzetë e dy) nxënës ($153-131=22$) që janë mbetës në Gjuhë Shqipe janë konsideruar kalues në “testi i kombinuar” që ka bërë AKP.

Në “Tabela (rezultatet testi i kombinuar) Klasa 5” vëmë re se numri i nxënësve vlerësuar me notë 4 (domethënë mbetës) është 172 dhe kalueshmëria 86.68%

Ndërkohë, nga tabelat e ndërtuara për testet sipas lëndëve kemi:

Gjuhë Shqipe:	168 nxënës mbetës, kalueshmëria 84.18%, nota mesatare nuk jepet
Matematika:	275 nxënës mbetës, kalueshmëria 78.69%, nota mesatare 5.6
Dituri Natyre:	27 nxënës mbetës, kalueshmëria 97.45%, nota mesatare nuk jepet

Nisur nga fakti se një nxënës konsiderohet mbetës në klasë kur ai është i tillë të paktën në një lëndë, atëherë për Klasën 5 do të kishim këtë situatë:

Numri minimal (rasti më i mirë i mundshëm) i nxënësve mbetës nga 1291 nxënësit e testuar është 275, aq sa është numri i nxënësve mbetës në lëndën Matematikë (ky është numri më i madh i mbetësve ndër tri lëndët në testim), ngjarje që ka gjasa të ndodhë .

Në këtë rast kalueshmëria do të ishte: $[(1291-275)/1291]*100\% = 78.69\%$, pra jo 86.68% sa thotë Raporti publik por goxha më e vogël.

Numri maksimal (rasti më i keq i mundshëm) i nxënësve mbetës nga 1291 nxënësit e testuar do të ishte $168+275+27=470$, që merret duke supozuar që nxënësit mbetës në njërin lëndë nuk janë të tillë në dy lëndët e tjera, ngjarje që ka gjasa të ndodhë.

Në këtë rast kalueshmëria do të ishte: $[(1291-470)/1291]*100\% = 63.59\%$, pra jo 86.68% sa thotë Raporti publik por shumë më e vogël. Për klasën e pestë gabohet shumë, gabohet nga 10 (dhjetë) pikë përqindje deri në 23 (njëzetë e tre) pikë përqindje.

Sipas logjikës së raport-hartuesve, del se të paktën 103 (njëqind e tre) nxënës ($275-172=103$) që janë mbetës në Matematikë janë konsideruar kalues në “testi i kombinuar” që ka bërë AKP.

Diskutim dhe mendime mbi disa shifra të Raportit publik

Në raport përgjithësisht bëhet fjalë për mesatare të pikëve të arritura, për kalueshmëri në përqindje për secilin nga testet e lëndëve dhe për notë mesatare (vetëm në lëndën Matematikë Klasa 3 dhe klasa 5).

Në dokumentet shkollore, kur bëhet fjalë për rezultate përfundimtare në një lëndë apo provim, kalueshmëria shoqërohet edhe me notën mesatare. Mungesa e mesatares së notës për lëndët Gjuhë Shqipe dhe Dituri Natyre, përveç se është i pajustificueshëm, fletë për një punë jo me standarde të AKP. Por le të analizojmë atë që kemi, mesataren e notës në testin për lëndën Matematikë Klasa 3 dhe 5.

Për lëndën Matematikë Klasa 3, raporti jep këto tregues:

Kalueshmëria 88%, Nota mesatare 6.5 [Raporti publik faqe 23].

I referohem tabelës nga ku nxirren këto tregues.

Tabela (rezultatet Matematikë) Klasa 3

Pikë	0-5	6-8	9-11	12-14	15-16	17-18	19-20
Nota	4	5	6	7	8	9	10
nr.nx	123	244	215	124	131	89	136

Çdo mësues, dhe jo vetëm, që do të kishte përpara këtë tabelë do të ishte në gjendje të nxirrte kalueshmërinë dhe notën mesatare, duke bërë këto veprime:

Për Kalueshmërinë: $[1062-123]/1062*100\% = 88.42\%$

Për Notën mesatare:

$[123*4+244*5+215*6+124*7+131*8+89*9+136*10]/1062=7079/1062 = 6.67$

Të dy rezultatet që dalin nga llogaritja janë ndryshe nga ato të raportit por, ndërsa për kalueshmërinë ndryshimi është vetëm 0.42% dhe mund të konsiderohet i papërfillshëm (megjithëse nuk ka arsye të ndodhë në një raport ku pretendohet se janë përdorur metoda statistikore që japin saktësi të lartë!), për notën mesatare ka gabim, sipas meje, të konsiderueshëm.

Gabimi prej 0.17 nuk vjen si rezultat i ndonjë përafrimi të mundshëm që mund të jetë përdorur (përafrimi me të dhjeta i 6.67 jep notën mesatare 6.7 dhe jo 6.5).

Për lëndën Matematikë Klasa 5, raporti jep këto tregues: Kalueshmëria 74.36%, Nota mesatare 5.6 [Raporti publik faqe 41]. I referohemi tabelës përkatëse nga ku nxirren këto tregues.

TABELA (REZULTATET MATEMATIKË) KLASA 5

Pikë	0-5	6-8	9-11	12-14	15-16	17-18	19-20
Nota	4	5	6	7	8	9	10
nr.nx	275	174	184	179	195	188	96

Çdo mësues, dhe jo vetëm, që do të kishte përpara këtë tabelë do të ishte në gjendje të nxirrte kalueshmërinë dhe notën mesatare, duke bërë këto veprime:

Për Kalueshmërinë: $[1291-275]/1291*100\% = 78.70\%$

Për Notën mesatare:

$[275*4+174*5+184*6+179*7+195*8+188*9+96*10]/1291=8539/1291 = 6.61$

Të dy rezultatet që dalin nga llogaritjet janë të ndryshëm nga ato të raportit. Por, në krahasim me rezultatet e Klasa 3, për Klasa 5 gabimet janë thelluar.

Për kalueshmërinë gabimi është: $78.70 - 74.36 = 4.34\%$. Ky ndryshim në kalueshmëri i "përkthyer" në numër nxënës do të thotë se Klasa 5 në testin e Matematikës nuk ka 275 (dyqind e shtatëdhjetë e pesë) nxënës por plot 331 (treqind e tridhjetë e një) të tillë. Me këtë shifër të re, të gjitha rezultatet, konkluzionet dhe rekomandimet e Raportit publik "hidhen në erë".

Për notën mesatare gabimi është: $6.61 - 5.6 = 1.01$, jo vetëm i konsiderueshëm por e pa imagjinueshme që ta injorosh. Gabohet me mbi një notë. Ç'bëhet kështu?!

Lidhur me "raportin" Kalueshmëri – Notë mesatare dhe se çfarë duhet të përfaqësojë Nota Mesatare, po shpreh një opinion timin të cilin e hedh edhe për diskutim në radhët e mësuesve.

Po sjell këtë situatë (me gjasa që ndodh): Në një Qytet janë dy shkolla të Mesme, Shkolla 1 dhe Shkolla 2. Rezultatet ndër vite për lëndën e Matematikës për të dyja këto shkolla janë të qëndrueshme dhe në një nga vitet shkollore kanë patur këto rezultate:

Rezultatet në Provimin e Matematikës Klasa 12, Shkolla 1

Nota	4	5	6	7	8	9	10
nr.nx	10	50	20	10	5	3	2

Kalueshmëria: $[90/100]*100\% = 90\%$

Nota mesatare (1), përfshihen të gjithë nxënësit, metodologjia që përdoret në Raport $[10*4+50*5+20*6+10*7+5*8+3*9+2*10]/100=567/100= 5.67$

Nota mesatare (2), përfshihen vetëm nxënësit që janë kalues, e propozuar nga unë $[50*5+20*6+10*7+5*8+3*9+2*10]/100=527/90= 5.85$ Diferenca e notës mesatare: $5.85 - 5.67 = 0.18$

Rezultatet në Provimin e Matematikës Klasa 12, Shkolla 2

Nota	4	5	6	7	8	9	10
nr.nx	30	10	10	15	15	10	10

Kalueshmëria: $[70/100]*100\% = 70\%$

Nota Mesatare (1), përfshihen të gjithë nxënësit, metodologjia që përdoret në Raport $[30*4+10*5+10*6+15*7+15*8+10*9+10*10]/100 = 645/100 = 6.45$

Nota mesatare (2), përfshihen vetëm nxënësit që janë kalues, e propozuar nga unë $[10*5+10*6+15*7+15*8+10*9+10*10]/100 = 525/70 = 7.5$ Diferenca e notës mesatare: $7.5 - 6.45 = 1.05$

Krahasimi i rezultateve të dy shkollave:

Shkolla 1: Kalueshmëria 90% ; Nota M mesatare (1) 5.67 ; Nota M mesatare (2) 5.85

Shkolla 2: Kalueshmëria 70% ; Nota M mesatare (1) 6.45 ; Nota M mesatare (2) 7.5

Pyes:

MAS dhe DAR, cila shkollë ka rezultate më të mira?

Mësuesit e Matematikës, në cilën shkollë do të kishin dëshirë të jepnin mësim?

Prindërit, në cilën shkollë do dëshirojnë t'i çojnë fëmijët e tyre?

Unë, si mësues dhe prind, e kam zgjedhjen, Shkolla 2. Mendoj se në “raportin” Kalueshmëri – Notë mesatare prioritet duhet të ketë nota mesatare. Kur flas për notë mesatare preferoj t'i referohem “Nota mesatare (2), përfshihen vetëm nxënësit që janë kalues”. Mendoj kështu pasi kjo është më “reale”. Kur flasim për Notë Mesatare, nga përvoja, kemi parasysh cilësinë. Nxënësit mbetës, ç'mund të flasim për cilësi kur ata do të duhet t'i rikthehen edhe njëherë programit të lëndës për të marrë së pari notë kaluese? Mund të thosha se “kontributi” i nxënësve mbetës për klasën apo shkollën në lëndën përkatëse është dhënë tek kalueshmëria. Për cilësinë “kontribuojnë” ata që kanë kaluar, më së shumti nxënësit me nota të mira dhe shumë të mira.

Kontrollorët, për testin e Matematikë Klasa 5, kanë raportuar mesatare 8.09 pikë [Raporti publik faqe 42]. Nuk i disponoj provimet e nxënësve për të verifikuar saktësinë, prandaj po kërkoj ta gjej mesataren e pikëve për çdo nxënës, sigurisht nga të dhënat e raportit, por në mënyrë të tërthortë. Sipas treguesve

[Raporti publik faqe 44], kemi këto rezultate për mesataren:

Sipas treguesit “Vendi”: $(7.31*531+8.58*760)/1291 = 10402.41/1291 = 8.05$ pikë

Sipas treguesit “Gjinia”: $(9.21*587+7.83*704)/1291 = 10918.59/1261 = 8.45$ pikë

Sipas treguesit “Pronësia”: $(9.93*175+8.47*1116)/1291 = 11190.27/1291 = 8.66$ pikë

Sipas treguesit “Cikli”: $(7.97*921+8.23*230+7.80*140)/1291 = 10325.27/1291 = 7.99$ pikë

Të jemi të qartë, mesatarja e pikëve të nxënësve të testuar është një dhe vetëm një pavarësisht nga ndarja e tyre në fshat qytet, femra-meshkuj etj.

Ndërkaq kemi pesë vlera të saj, që janë: 8.09 ; 8.05; 8.45; 8.66; 7.99.

Cila është mesatarja e saktë e pikëve që është arritur nga nxënësit e klasës së pestë të testuar në lëndën Matematikës? Më e pakta që të vjen ndërmend të thuash është se shifrat janë të manipuluar me qëllim që të arrihet tek konkluzioni i paravendosur, se për ndryshe duhet të pranojmë që kontrollorët nuk dinë të nxjerrin një mesatare pikësh apo note, gjë që i kërkohet dhe duhet ta dijë çdo mësues, me patjetër .

Analizë e të dhënave për disa tregues të Raportit

Në raport, në rubrikën “Disa nga arritjet në nivel kombëtar” për klasën e tretë dhe të pestë, thuhet:

Niveli kombëtar i arritjes është mbi mesatar. Nxënësit e klasës së 3-të dhe të 5-të janë në gjendje që mesatarisht të zgjidhin më shumë se gjysmën e kërkesave të testit.

Nxënësit e qytetit kanë arritje thuajse të njëjta me ata të fshatit

Vajzat kanë arritje pak më të larta se djemtë (për të dy klasat)

Shkollat private kanë arritje më të larta se ato publike (për të dy klasat)

Nuk thuhet asgjë për treguesin lloj sipas ciklit (9-vj, BM, CU).

1. Çdo të thotë “Nxënësit e klasës së 3-të (edhe të 5-të) janë në gjendje që mesatarisht të zgjidhin më shumë se gjysmën e kërkesave të testit”? Le ta thjeshtojmë situatën:

E zëmë se shkolla ka 50 (pesëdhjetë) nxënës, nga të cilët 20 (njëzetë) prej tyre kanë marrë maksimumin e pikëve dhe vlerësohen me notën 10 (dhjetë) ndërsa 30 (tridhjetë) të tjerët kanë marrë nga 10 (dhjetë) pikë, nga 50 (pesëdhjetë) pikë të mundshme, dhe vlerësohen me notën 4 (katër).

Mesatarisht janë marrë: $(20*50 + 30*10)/ 50 = 1300/50 = 26$ pikë

Atëherë, sipas kontrollorëve të AKP, duhet të kënaqemi pasi “nxënësit e kësaj shkolle janë në gjendje që mesatarisht të

zgjidhin më shumë se gjysmën e kërkesave të testit" edhe pse në këtë shkollë janë mbetës 60% (gjashtëdhjetë përqind) e nxënësve.

Përfundim interesant, njëlloj siç mund të themi: Jemi ulur në tavolinën e ngrënies Unë dhe Ti. Unë kam përpara një pulë dhe një sallatë domate, Ti ke vetëm sallatë domate. Mesatarisht të dy kemi nga një gjysmë pule dhe nga një sallatë! Hajde pra, na bëftë mirë!

2. Kontrollorët, pavarësisht se për testin e kombinuar nuk kanë paraqitur të dhëna, pohojnë:

Nxënësit e qytetit kanë arritje thujse të njëjta me ata të fshatit (për të dy klasat)

Vajzat kanë arritje pak më të larta se djemtë (për të dy klasat)

Shkollat private kanë arritje më të larta se ato publike (për të dy klasat)

Nuk thuhet asgjë për treguesin lloj sipas ciklit (9-vj, BM, CU) (për të dy klasat)

Të dhëna për arritjet e nxënësve sipas përkatësisë: qytet - fshat, femra-meshkuj, shkollë private - shkollë publike, lloji sipas ciklit, për secilën nga tre lëndët e testuar, jepen në Pjesën II dhe III të Raportit [Raporti publik, faqe 20, 26, 32, 38, 44, 50].

Për të mundësuar analizën, nga të dhënat e raportit po ndërtoj tabelën e mëposhtme:

Treguesi	Lloji	Nr.nx	Mesatarja e pikëve në gjuhë shqipe	Mesatarja e pikëve në matematikë	Mesatarja e pikëve në dituri natyre
Vendi	Fshat	464	11.11	10.67	5.34
	Qytet	598	10.76	10.71	6.37
Gjinia	Femra	473	11.36	10.87	6.25
	Meshkuj	589	11.41	10.54	6.89
Pronësia	Private	86	12.94	12.95	5.98
	Publike	976	10.32	10.51	6.46
Cikli	9-vj	776	11.11	10.70	5.62
	BM	164	10.46	10.76	6.37
	CU	122	10.45	10.37	6.44

KLASA 5

Treguesi	Lloji	Nr.nx	Mesatarja e pikëve në gjuhë shqipe	Mesatarja e pikëve në matematikë	Mesatarja e pikëve në dituri natyre
Vendi	Fshat	531	12.36	7.31	6.31
	Qytet	760	14.01	8.58	6.21
Gjinia	Femra	587	14.51	9.21	6.42
	Meshkuj	704	12.11	7.83	6.02
Pronësia	Private	175	14.12	9.93	6.21
	Publike	1116	13.11	8.47	5.87
Cikli	9-vj	921	13.63	7.97	5.78
	BM	230	12.04	8.23	6.31
	CU	140	13.01	7.80	6.01

a) Diferenca e mesatareve Qytet-Fshat, klasa 5, është:

Gjuhë Shqipe: $14.01 - 12.36 = 1.74$ pikë më shumë për nxënësit e Qytetit

Matematikë: $8.58 - 7.31 = 1.47$ pikë më shumë për nxënësit e Qytetit

Dituri Natyre: $6.31 - 6.21 = 0.10$ pikë më shumë për nxënësit e Fshatit

Gjithsesi, konkluzioni i nxjerrë në raport se "Nxënësit e qytetit kanë arritje thujse të njëjta me ata të fshatit", për klasën e pestë nuk qëndron. E vogël u duket kjo diferencë, në lëndët Gjuhë Shqipe dhe Matematikë, kontrollorëve tanë? Nëse "Nxënësit e qytetit kanë arritje thujse të njëjta me ata të fshatit" atëherë si duhet ta kuptojmë konkluzionin "...Ekzistenca e niveleve të ndryshme të cilësisë në mësimdhënie gjatë procesit mësimor, kjo më e dallueshme mes qytetit dhe fshatit" në

rubrikën “Faktorët që mund të kenë ndikuar në këto rezultate” [Raporti publik faqe 9]. Pra, sipas raportit, nuk ka dallime në arritjet e nxënësve sipas treguesit fshat-qytet, ndërkohe që ka nivele të ndryshme të cilësisë në mësimdhënie gjatë procesit mësimor. Hajde e merre vesh këtë punë! Diferencë, edhe kaq sa thonë rezultatet në Raport, ka mjaftueshëm, unë prisja diferencë edhe më të madhe nisur nga fakti se në ç’kushte dhe me ç’mësues bëhet mësim në shkollat e fshatrave, sidomos në ato të zonave të thella malore. Dyshoj se diferencën e ka “zbutur” ndonjë faktor si ai që nënkuptohet nëse lexon me vëmendje rekomandimin “Administrim më i fortë i procesit të testimit” [Raporti publik faqe 11] të vetë Raportit publik.

b) Diferenca e mesatareve Femra-Meshkuj, klasa 5, është:

Gjuhë Shqipe: $14.51 - 12.11 = 2.40$ pikë më shumë për nxënëset Femra

Matematikë: $9.21 - 7.83 = 1.38$ pikë më shumë për nxënëset Femra

Dituri Natyre: $6.42 - 6.02 = 0.40$ pikë më shumë për nxënëset Femra

Konkluzioni se “Vajzat kanë arritje pak më të larta se djemtë” qëndron, madje, mund të hiqet fare fjala “pak”, pasi ndryshimi është i dukshëm. Ndërkohë nuk kuptoj kontrollorët që, në rastin e treguesit Femra-Meshkuj u bën “pak përshtypje” ndryshimi ndërsa në rastin e treguesit Fshat – Qytet “nuk u bën fare përshtypje”. A mos jemi në rastin e një gjykimi subjektiv? A duhet të ketë standarde të mirë përcaktuara se ç’do të quhet dallim?

c) Diferenca e mesatareve Private-Publike, klasa 5, është:

Gjuhë Shqipe: $14.12 - 13.11 = 1.01$ pikë më shumë për nxënësit në shkolla Private

Matematikë: $9.93 - 8.47 = 1.46$ pikë më shumë për nxënësit në shkolla Private

Dituri Natyre: $6.21 - 5.87 = 0.34$ pikë më shumë për nxënësit në shkolla Private

Konkluzioni se “Shkollat private kanë arritje më të larta se ato publike” qëndron. Por nuk kuptoj specialistët e AKP që në rastin e këtij treguesi, diferenca “u bën përshtypje”, megjithëse diferencat në të tre treguesit (fshat-qytet, femra-meshkuj, private-publike) janë aty-aty.

d) Diferenca e mesatareve sipas ciklit të shkollës, klasa 5, është:

Gjuhë Shqipe: më mirë shkollat 9-vjeçare, me 1.59 pikë më shumë

Matematikë: më mirë shkollat BM, me 0.26 pikë më shumë

Dituri Natyre: më mirë shkollat BM, me 0.30 pikë më shumë

I pakuptueshëm është fakti që në Raport, për këtë tregues, nuk jepet ndonjë konsideratë se cili nga ciklet e shkollave ka arritje më të mira dhe, mbi këtë bazë, të jepet edhe ndonjë rekomandim. Në rast se nuk e analizon, përse e evidenton këtë tregues?!

Konkluzione dhe Rekomandime

Raporti publik “Vlerësimi Kombëtar për lëndët: Gjuhë Shqipe, Matematikë, Dituri Natyre, klasa 3 dhe 5”, në këndvështrimin tim, lidhur me atë që vetë raporti ka si synim: “të paraqesë në mënyrë përshkuese dhe statistikore arritjet e nxënësve në klasën e 3-të dhe të 5-të, në lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre” nuk është më i miri i mundshëm. Raporti nuk është parë dhe paraqitur si një i tërë, grupet e punës duket se kanë vepruar veçmas për secilën lëndë pa u kujdesur që “tre raportet” të harmonizoheshin në metodikë, në kërkesa, në të dhënat e grumbulluara, në përpunimin e të dhënave dhe, më kryesorja, në ruajtjen e standardeve.

Raporti pretendon “ të japë informacion për autoritet arsimore dhe publikun e gjerë, për rezultatet e nxënësve në këto klasa, për periudhën shtator-prill 2013 -2014”. Do të thosha se në mjaft raste informacioni nuk është i saktë, ka gabime të qenësishme që mund të informojnë jo saktë autoritetet arsimore dhe publikun e gjerë.

Hartuesit e raportit nuk janë konsequent në interpretimin e të dhënave. Të dhëna të njëjta apo shumë të përafërta për tregues të ndryshëm interpretohen subjektivisht duke arritur deri aty sa të konsiderohen të qenësishme diku e të injorohen diku tjetër.

Bibliografia

Raport publik “Vlerësimi Kombëtar për lëndët: Gjuhë Shqipe, Matematikë, Dituri Natyre, klasa 3 dhe 5” Faqja zyrtare e AKP, MAS “Nxënësit e filllores në nivele analfabetizmi” Gazeta Mapo, dt. 17.02.2015

“Nxënësit shqiptarë në nivelin mesatar, degët e mësuesisë i zgjedhin më të dobët” Gazeta Mapo, dt. 24 .02. 2015

MBI DEBATIN DHE SHPËRNDARJEN E IDEVE NEOLIBERALE NË EUROPËN LINDORE

BESART KADIA, PHDC

Universiteti European i Tiranës

ABSTRAKT

Neoliberalizimi është një fjalë e përdorur gjerësisht në rangjet akademike në botë pas vitit 1990 por serish ajo mbetet e vështirë për t'u përkufizuar qartë se çfarë është. Gjithashtu është e vështirë të përdoret fjala në kuptimin pozitiv apo si një formë e vetë-identifikimit ideologjik. Thorsen (2009) beson se neoliberalizimi është një koncept i nevojshëm për të kuptuar kërkesat e fundit për rregullim të tregjeve, reforma në sektorin publik që do t'i bënte agjencitë publike më të ngjashme me ato private megjithëse nuk është e qartë se si ky trend është njëkohësisht i ri (neo) dhe liberal. Ky punim bën një përmbledhje të debateve të fundit mbi këtë rrymë të mendimit ekonomik dhe sesi ajo është përhapur në vendet e Europës Lindore pas rënies së komunizmit.

1. Hyrje

Nga vetë fjala neoliberal mund të mendohet që bëhet fjalë për një ringjallje të liberalizimit klasik. Ky interpretim intuitiv do të nënkuptonte se idetë liberale kanë munguar për një kohë të gjatë nga debatet politike dhe politikbërjes dhe tani ajo po rikthehet nga një sukses në fillimet e saj, e pasuar me rënie dhe së fundmi me ri ngritje. Nga ana tjetër fjala neoliberal mundet të nënkuptojë një ideologji të veçantë nga liberalizmi fillestar me rrënjë të përbashkëta, por jo të njëjta. Për të kuptuar neoliberalizmin është e rëndësishme të rikthehemi dhe njëherë në kuptimin e fjalës liberal, ku sipas Ryan (1993) është e rëndësishme të bëhet dallimi mes liberalizmit klasik dhe atij modern. Liberalizmi klasik sipas Ryan i atribuohet Xhon Lok dhe Adam Smith si dhe Alexis de Tocqueville dhe Friedrich von Hayek si përfaqësues të rinj të ideve klasike të liberalizmit.

2. Mënyra e shpërndarjes së Ideve Neoliberale në Evropën Lindore

Në 1989 John Uilliamson (1993: 1334) formuloi atë që ai e përshkroi si “ një program të konvergencës universale” që përbëhej nga një besim i përbashkët i të gjithë ekonomistëve serioz duke ofruar një listë me dhjetë pika ku përfshihej disipline fiskale, heqja e e subvencioneve në ekonomi dhe orientimi i shpenzimeve në shëndetësi, edukim dhe infrastrukturë, ulje të taksave, liberalizim financiar, kurs këmbimi të lirë, liberalizim të tregtisë me jashtë, hapje ndaj investimeve të huaja direkt, privatizim, de-rregullim dhe sigurimi i pronës private. Këto reforma quheshin Konsensusi i Uashingtonit pasi Kongresi Amerikan, teknokratët në Uashington, institucione ndërkombëtare financiare, agjenci të shtetit Amerikan, Rezerva Federale, think tanks të ndryshëm ishin në dakordsi se politika të kujdesshme makroekonomike dhe kapitalizëm i tregut të lirë duhej të implementohej mbi pjesën tjetër të botës. (Uilliamson 1990, 1993). Kjo ide universale e politikave shihet dhe në përkufizimin që bën Gray pak më sipër se “*liberalët vlerësojnë unitetin moral të qenieve njerëzore duke i dhënë rëndësi të dorës së dytë formave kulturore apo asocimeve historike*”.

Me rënien e Murit të Berlinit programet e stabilizimit u aplikuan për herë të parë nga ekonomisti i Harvardit Jeffrey Sachs, pas efekteve në Bolivi në 1985, dhe u rishikua dhe u shpërnda nga ekipi i tij në Poloni dhe Rusi. Kjo “terapi e shokut” kërkonte transformimin e një shoqërie të centralizuar drejt një ekonomie tregu. Idetë pro tregut nuk ishin në qarkullim vetëm në akademi dhe në pres, por ato u bënë instrumente politikash për shumë institucione financiare ndërkombëtare. Gjatë viteve 1990 FMN, Banka Botërore dhe BERZH vendosën që kredia mundet të merrej në rast se shtetet që do merrnin kredi do të aplikonin paketën e reformave neoliberale në ekonomi. Këto politika vinin si pasojë e besimit të madh që kishin këto institucione mbi fuqinë dhe efikasitetin e tregu dhe kërkonin të zvogëlonin deri në minimum rolin e shtetit” [Stiglitz 2008, 41].

Në Evropën Lindore rënia e sistemit komunist la një vakum ideologjik që bëri tërheqës superioritetin e tregjeve dhe demokracive liberale që vinin nga Perëndimi. Në këtë kohë shumë lider sindikatash dhe parti politike socialiste dërguan delegacione për të bindur liderët e rinj që reformat që do të ndërmerrenin të kishin në plan demokracitë sociale. Por elita e re ishte më e bindur mbi tregjet e lira. Sipas Blyth (2002) aplikimi i ideve të Kejnstit dhe më pas ato neoliberale nuk vijnë si pasojë e një interpretimi më “të vërtetë” të realitetit, por më tepër një akses më i madh në media dhe në elitën politike të këtyre ideve. Shumë prej mbështetësve të neoliberalizmit në fillim të viteve 1990 ishin konvertuar së fundmi dhe me shumë pak trajnim në ekonomistin e tregjeve të lira. Për shembull Yegor Gaidar dhe Vaclav Klaus, të dy të trajnuar si ekonomistë në një sistem socialist por që ndërmorën reformat ekonomike në Rusi dhe Çeki u bënë mbështetës të hapur të ideve neoliberale vetëm në fund të viteve 1980. Në Letoni idetë neoliberale u promovuan nga një grup ekonomistësh të rinj të rikthyer të njohur si “banda Gerogetoën” etj.

Sipas Ruthland pavarësisht kësaj shumë prej reformatorëve të Evropës Lindore po ndërmerrenin reformat pa një hartë të qartë. [Shleifer & Treisman 2001]. Ata duhet të huazonin ide dhe eksperiencat të shteteve të tjera që mund t’i vinte në ndihmë atyre. Shumë prej kritikëve në fakt lidhin reformat e tregut me idetë ekonomike libertarianë të Friedrich Hayek të njohur si shkolla Austriake e Ekonomisë. Por në të vërtetë një interpretim Haykain i mënyrës së implementimit të reformave në Evropën Lindore nëpërmjet Konsensusit të Uashingtonit nuk është aspak një qëndrim që do mbështetej prej tij. Hayek besonte se rendi shoqëror duhet të vij spontanisht nga individë që kërkojnë të arrijnë interesat e tyre dhe jo si rezultat i ndonjë arkitekturë të rendit global [Petsoulas 2001]. Ndaj kjo çon në diskutimin nëse kjo ishte imponim apo përvetësim i ideve neoliberalë në Evropën Lindore.

3. Shpërndarja apo imponimi i ideve neoliberale

Politologë të shumtë, ekonomistë apo dhe sociolog janë munduar të analizojnë arsyet e shpërndarjes së liberalizmit ekonomik dhe politik në shumë shtete të botës gjatë dekadave të fundit. Shumë ekonomistë besojnë se përfitimet nga liberalizmi i politikave ekonomike për vendet në zhvillim renditen në miliarda dollarë. Por gjithashtu nënvizojnë destabilitetin pasigurinë njerëzore si pasojë e liberalizmit. Pyetja që shtrohet është se cilat janë arsyet që shumica e botës ka përqafuar tregun dhe demokracinë? Supozimi kryesor është se politikat kombëtare në ekonomi nuk mundet të zgjidhen të veçuara nga shtete të tjera dhe shpesh ato janë kundërpërgjigje e asaj se çfarë bëjnë vendet e tjera. Sipas Beth mekanizmat e shpërndarjes së këtyre ideve janë katër: detyrimi (coercion), konkurrenca, mësimi dhe imitimi në librin e tij *The International Diffusion of Liberalism (Beth, 2006)*

3.1 Detyrimi

Ky është një interpretim antiliberale i dhënë shpesh për arsyen përse idetë liberale janë shpërndarë kaq shumë në botë. Shtete të pasura dhe të fuqishme mundet të influencojnë vendet e varfra dhe të vogla në mënyre direkt dhe indirekte. Ky lloj mekanizmi pra shfrytëzon fuqinë asimetrike që vendet e pasura imponojnë mbi ato të vogla dhe në zhvillim. Sipas kësaj ideje vendet e pasura kanë arsye dhe qëllim të qartë se përse duan të ndryshojnë politikat në vendet e pasura dhe në rast se këto shtete nuk do të kishin fuqinë e tyre imponuese atëherë ato do të zgjidhnin të rezistonin. Sipas kësaj teorie shtetet e fuqishme mund të përdorin fuqinë që lind në marrëdhënie bilaterale ose nga entitete kolektive që funksionojnë si agjentë apo si aleatë. Gjithashtu sipas këtij interpretimi aktorë privat mundet gjithashtu të luajnë rol të rëndësishëm. Si për shembull banka private apo dhe kushtet e vendosura nga FMN (Gould, 2003).

Një arsye tjetër që paraqitet nga studiuesit është dhe kushtëzimi i “lehtë”. Politikat e shteteve të fuqishme shpesh herë konsistojnë në koordinim politikash me ekulibre të ndryshme. Shtetet dominuese adoptojnë politika, si për shembull Nënshkrimi i Bazelit për të kontrolluar tregjet e kapitalit dhe rregullat e saj, që vendosin një ekuilibër ku dhe shtete e varfra janë të detyruara që të marrin pjesë.

Kërkesa më forcë për të implementuar politika të tilla ka pak gjasa të jenë të suksesshme, ndërsa politika “go it alone” bëji vetë nga ana e shteteve të mëdha çojnë në një ekuilibër të tillë sa shtetet e vogla nuk kanë mundësi të tjera veçse ti bashkohen këtyre politikave.

Për të analizuar se nëse forca përdoret për të implementuar politika liberale duhen analizuar aktorët të cilët i implementojnë këto pulitka në rendin global. Në rast se FMN është burimi i fuqishëm i ideve neoliberalë si një agjent de facto që ofron dhe financim për shtetet në zhvillim, atëherë mundet të vihet re dhe empirikisht se ato shtete që kanë qenë të varura nga financimi i FMN-së kanë përfunduar me politika neoliberalë.

3.2 Konkurrenca

Konkurrenca është një mekanizëm më i decentralizuar për të shpërndarë politikat se sa detyrimi. Teoricienë të shpërndarjes së ideve liberale nëpërmjet konkurrencës theksojnë faktin se shtetet nuk janë njësoj tërheqëse për investitorët dhe tregjet ndërkombëtare. Sipas kësaj teorie drejtuesit e këtyre shteteve janë në konkurrencë konstante me shtete të tjera për të tërhequr sa më shumë investitorë dhe për të rritur sa më shumë eksportet e tyre. Duke lehtësuar politikat rregulluese, duke përmirësuar klimën për investime ndërkombëtare dhe duke ulur barrën fiskale shihen si politika të suksesshme që mund të ta bëjnë ekonominë më tërheqëse eksportet më konkurruese dhe ekonominë më vitale. Por kjo teori propozohet si nga ata teoricienë që thonë se kjo i bën shtetet me politika më efikase dhe konkurruese në nivel ndërkombëtar ashtu dhe nga ata që e shohin këtë si një “garë drejt fundit” pasi shtetet ulin taksat, ulin shpenzimet sociale, heqin rregullat mjedisore dhe rregullat e tregut të punës për të tërhequr këta investitorë.

Në këtë interpretim në rast se teoria e detyrimit thoshte se imponimi i politikave liberale vinte si efekt i marrëdhënies vertikale, kjo teori shpjegon se konkurrenca mes shteteve të ngjashme sjell dhe shpërndarjes e këtyre ideve në mënyrë horizontale.

3.3 Të mësuarit

Kjo teori i referohet ndryshimit të besimit ose të konfidencës për njohuritë aktuale pasi ekspozohesh në të dhëna të reja apo dhe teori të reja. Në fushën e zgjedhjes së politikave publike aktorë të ndryshëm duhet të bëjnë zgjedhjet në nivelin e thjeshtë taktik se si të arrish më mirë një objektiv të caktuar sikundër dhe në një nivel më të thellë se cilat objektiva duhen ndjekur. Sipas kësaj teorie zgjedhjet e bëra nga shtetet e tjera nuk ndikojnë në mirëqenien tënde direkte, siç pretendonin dy teoritë e lartpërmendura, përkundrazi kjo teori thotë se vendimet e shteteve të tjera ofrojnë për shtetin tënd ide të reja dhe të dhëna të reja.

Kërkime të fundit për mënyrën sesi shtetet në zhvillim formulojnë dhe implementojnë politika si reforma në pensione apo regjimi i kursit të këmbimit deri të programet e privatizimit tregojnë rëndësinë e të mësuarit nga shtetet fqinje. Është e dokumentuar në literaturën ndërkombëtare se procesi i negociatave dhe mbajtja e marrëdhënies institucionale janë një mënyrë për të krijuar mundësi për të mësuar dhe bindur.

3.4 Imitim (Garë)

Sociologët kanë studiuar shpërndarjen e politikave nëpërmjet lenteve të “konstruktivizmit social”. Konstruktivizimi social u bë një paradigmë e teorisë ndërkombëtare në fund të viteve 1990. Mbështetësit e kësaj teorie thonë se për të kuptuar sesi shpërndahen idetë është e rëndësishme të kuptojmë sesi ato bëhen të pranueshme nga ana e shoqërisë. Një mënyrë është marrja e vendeve të mëdha si një shembull për të nisur reformat por kjo e bën të vështirë të kuptohet sa është imitim dhe sa është imponim. Një mënyrë tjetër është artikulumit në publik i ideve apo reformave nga grupe të ndryshme interesi të cilat mendohen nga shoqëria si grupe të pavarura dhe objektive. Siç mundet të jenë idetë e artikuluara nga organizatat jo qeveritare apo ekspertë të huaj dhe që më pas përqafohen nga shteti. Gjithashtu shembuj jepen në literaturë për sa i përket trajnimit në ide liberale që morën ekonomistë të ndryshëm të Amerikës Latine në Universitetet Amerikane. Të tjerë do të shtonin se reformat ndërmerren vetëm kur ato mundet të jenë të implementueshme nga vendet e varfra, por implementimi i disa prej politikave ndërkombëtare ndërmerren për arsye simbolike, sidomos në politika sociale apo të ILO (Organizata Ndërkombëtare e Punës).

4. Kritikët e Majtë

Shumë autorë perëndimorë shkruajnë se neoliberalizimi është ideologjia e cila po udhëheq botën sot. Por shpesh herë neoliberalizimi përdoret me përçmim dhe në keqardhje e shohin si avancimi i kapitalizmit dhe konsumerizimit në dëm të shtetit social (Bourdieu 1998; 1998a; 2001; Chomsky 1999; Touraine 2001; Harvey 2005; Hermansen 2005; Saad-Filho and Johnston 2005; Hagen 2006; Plehwe et al. 2006).

Sipas akademikut të majtë David Hurley (2005, f.6-7) neoliberalizimi është mbi të gjitha:

“një teori e praktikave të politikave ekonomike e cila propozon se mirëqenia e njerëzve mund të arrihet vetëm nëse ne lejojmë liritë dhe aftësitë sipërmarrësve të individëve brenda një kornize institucionale e karakterizuar nga ligje të forta të pronës së lirë, tregjeve të lira dhe tregtisë së lirë. Roli i shtetit është të lejojë dhe të ruajë këto korniza institucionale të nevojshme për të arritur qëllimet e lartpërmendura. Në ato raste kur tregu nuk ekziston në sektorë të tillë si tokë, ujë, edukim, shëndetësi, sigurime shoqërore) atëherë ato duhen krijuar dhe me ndërhyrjen e shtetit nëse është e nevojshme. Përtej këtyre objektivave shteti nuk duhet të kalojë. Ndërhyrja e shtetit në ekonomi duhet të jetë në minimum dhe për arsyen se shteti nuk mundet të ketë informacionin e plotë për të marrë një vendim të drejtë dhe së dyti sepse grupe të forta interesi do të ndikojnë në vendimmarrjen shtetërore në benefit të tyre, sidomos në demokraci”.


Sipas Hurley neoliberalistët tashmë kanë pozicione të mira në institucionet globale si FMN, Bankë Botërore, OBT, Think Tanks, universitete, Ministri Financash dhe për këtë arsye ai mendon se neoliberalizimi është tashmë një diskurs i gjithëpushtetshëm duke patur efekte të thella duke u bërë gati *common-sense* në mënyrën se si ne mendojmë, jetojmë apo kuptojmë botën në të cilën jetojmë. Përkufizimi që vjen prej Harvey është një përkufizim i shtjellimit të mëtejshëm që ai i bën idesë neoliberale që sipas tij ka filluar të ketë efekt në politikat ekonomike që në vitet 1970-të. Sipas tij neoliberalizimi nuk është një rikthim në idetë liberale, por një teori e re dalluese e pavarur nga idetë liberale. Sipas tij Neoliberalizimi është “teori e praktikave të politikave ekonomike” dhe jo një ideologji politike e plotë. Sipas analizës së tij nuk ka një lidhje të drejtpërdrejt mes praktikave ekonomike neoliberale dhe një dedikimi në liberalizëm.

Sipas tij është e vështirë që të përkufizosh ose të tregosh karakteristikat e përbashkëta të shteteve neoliberale pasi divergjencat sistematike të teorive neoliberale janë lehtësisht të dukshme dhe së dyti dinamika e evoluimit të neoliberalizmit do të thotë që ajo ka marrë trajta të ndryshme në varësi të vendit por dhe të kohës kur ajo është implemtuar (Harvey, 2005, faqe 71).

Shtetet neoliberale duhet të riformohen nga brenda në mënyrë konstante dhe të ndërtojnë institucione të reja për të përmirësuar konkurrueshmërinë e tyre. Harvey (2005, f 64) thotë se Neoliberalët janë ithtar të privatizimeve. Mungesa e të drejtave të pronësisë për shumicën e qytetarëve në vendet në zhvillim e bën të rëndësishme që për të luftuar tragetin e të përbashkëtës (tragedy of the commons), ku qytetarët e mbi shfrytëzojnë të mirën publike si uji dhe toka. Duke ia lënë këtë përgjegjësi konkurrencës mes qytetarëve, firmave dhe entiteteve rajonale si komuna apo bashki arrihet që të eliminohet i gjithë procesi burokratik duke rritur efikasitetin dhe performancën me çmime më të ulta për qytetarët dhe me më pak shpenzime nga ana e qeverisë për administrimin e tyre.

David Kotz (2001, 2009) gjithashtu kritikon se për më shumë se 30 vjet kapitalizmi neoliberal ka prishur kushte e jetesës për shumicën në SHBA dhe rreth e qark botës. Tani kriza e fortë ekonomike dhe financiare po tregon pikat më të dobëta të kapitalizmit pasi motivimi i fitimit nuk mundet t’i shërbejë njerëzve për standarde jetese të mira si në shërbimet publike dhe private, siguri ekonomie dhe një ekonomi që të jetë i padëmshëm për mjedisin. Argumentet për një alternativë socialiste janë më të forta për miliona njerëz që kanë humbur kursimet e jetës, me papunësi të lartë etj. Një lëvizje socialiste do të rilind në të ardhmen duke hapur mundësinë për ti dhënë fund erës së kapitalizmit.

GRAFIK 1: RITJIA MESATARE PPB PËR FRYMË NË VENDET OECD. BURIMI: KOTZ



Sipas autorit Kotz të dhënat e tabelës flasin qartë se një kapitalizëm i rregulluar siç ishte në vitet 1950-73 dhe me ndërhyrje nga shteti nën idetë Kejnsoniane tregojnë qartë se PBB për frymë ka patur një rritje më të lartë sesa një treg i cili i nënshtrohet ideve neoliberales. Këta të fundit thonë se implementimi i këtyre ideve në SHBA dhe MB mundësuan rritje ekonomike mesatare të përafërt me periudhën 1950-73. Por siç dhe do të shohim më pas në punim arsyet e rritjes ekonomike më të shpejtë të këtyre vendeve pas luftës së dytë botërore kanë të bëjnë kryesisht me procesin e kthimit të lart të kapitalit në kushtet e shkatërrimit të saj pas luftës së dytë botërore.

Neoliberalizmi është problematik si një teori dominuese e kapitalizmit bashkëkohor. Stabiliteti dhe mbijetesa e sistemit kapitalist varet nga aftësia e tij për të akumuluar sasi të mëdha kapitali, si një ekspansion ekonomik ashtu dhe një progres teknologjik. Shqetësimet nga modeli i rritjes së kapitalit sjell problemin e pamjaftueshmërisë së kërkesës agregate në periudhën afatgjatë pasi regjimi neoliberal kërkon gjithnjë e më shumë ulje të pagës reale të punëtorëve dhe ulje të shpenzimeve publike.

Gjithashtu modeli neoliberal sjell mungesë të stabilitetit makroekonomik pasi hiqet dorë nga politikat kundër ciklike të qeverisë duke ulur programet sociale dhe pakësimin e rregullatorëve publik të sektorit financiar duke e bërë sistemin më vulnerable ndaj krizave të mëdha financiare. Së treti sistemi neoliberal intensifikon konfliktet klasore që potencialisht mundet të dëmtojnë investimet kapitale. Kotz vazhdon të argumentojë se globalizimi është një faktor kryesor që ka transformuar bizneset e mëdha nga mbështetës të një shteti ndërhyrës në të kundërtën, pasi ky proces ka rritur konkurrueshmërinë në nivel botëror duke i bërë ato të kërkojnë vende me taksë të ulëta, të bëjnë presion për të ulur barrierat hyrëse në shtete të ndryshme.

Bibliografia

- Boas, T.C. and GansMorse, J. (2010) Neoliberalism: from new liberal philosophy
 Gray, John (1995): Liberalism. 2nd Edition. Buckingham: Open University Press.
 David M. Kotz, (2001), Globalization and Neoliberalism, University of Massachusetts, website: http://people.umass.edu/dmkotz/Glob_and_NL_02.pdf
 Harvey, David (2005): A Brief History of Neoliberalism. Oxford: Oxford University Press.
 John Williamson, 2004, A Short History of the Washington Consensus” Conference “From the Washington ; Consensus towards a new Global Governance,” Barcelona, September 24–25, 200; <http://www.iie.com/publications/papers/elliason0904-2.pdf>
 Mark Blyth, Great Transformations: Economic Ideas and Institutional Change in the 20th Century (New York: Cambridge University Press, 2002)

TRANZITOLOGJIA: NJË KRITIKË ANTI-TELEOLOGJIKE

GERTI SQAPI

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, Shkenca Politike

ABSTRAKT

Përgjatë tri dekadave të fundit që nga lindja e saj, paradigma e tranzicionit (apo tranzitologjia) ka përbërë një nga paradigmat dominuese dhe me më shumë influencë në studimet e ndryshme mbi demokratizimin. Koncepti i “tranzicionit demokratik” ka qenë koncepti kryesor i përdorur për të shpjeguar ndryshimet politike në shumë vende që u larguan prej regjimeve të mëparshme autoritare/totalitare të tyre. Zhvillimi i literaturës dhe studimeve brenda kornizës konceptuale të tranzitologjisë në pjesën më të madhe të saj u bë pikërisht përgjatë periudhës të asaj që njihet edhe si vala e tretë e demokratizimit, dhe u bë edhe si një përgjigje ndaj ndryshimeve të shpejta të regjimeve që po ndodhnin në skenën politike botërore në atë kohë. Shpjegimi dhe madje edhe drejtimi i ndryshimeve nga regjimet autokratike drejt atyre demokratike të vendeve që u përfshinë në këtë valë të tretë, ishte pretendimi kryesor i qasjes së tranzitologjisë. Megjithatë, sot, dy dekada e gjysmë pas proklamimit të “fundit të historisë” me triumfin e presupozuar të demokracisë liberale, modeli i zhvilluar nga tranzitologët nuk vlen më për të shpjeguar realitetin dhe dinamikën politike të shumë prej vendeve të përfshira në valën e tretë, e as më pak faktin se shumë prej tyre nuk kanë shkuar drejt instutualizimit të plotë të demokracisë në mjediset e tyre. Synimi i këtij punimi është të hetohet mbi vlefshmërinë e kuadrit konceptual dhe supozimeve të qasjes së tranzitologjisë në lidhje me shpjegimin (si dhe drejtimin e ndryshimeve) të proceseve të demokratizimit të vendeve që u përfshinë në valën e tretë të demokratizimit.

Fjalë kyç: *tranzicion demokratik, konsolidim, shtrirje konceptuale, telos, agjenti, regjime hibride.*

1. Hyrje

Rënia e murit të Berlinit dhe përfshirja e një numri gjithmonë e më të madh vendesh në të ashtuquajturën “vala e tretë” e demokratizimit me përmbysjen e regjimeve të tyre të mëparshme autoritare/totalitare, i dha shtysën kryesore studimeve mbi tranzicionin. Duke u nisur nga eksperiencia e mëparshme e disa vendeve të demokratizuara në Europën Jugore (tek rasti i Spanjës kryesisht, por pa harruar edhe rastet e Portugalisë dhe Greqisë) dhe të pak vendeve në Amerikën e Jugut, të shtyrë sigurisht edhe nga entuziazmi i karakterizuar nga zhvillimet e reja që po ndodhnin në peizazhin politik botëror në fundin e viteve '80, një numër gjithnjë e më i madh veprash e studimesh mbi demokratizimin filluan të botoheshin “nën çatinë” e asaj që po bëhej një (nën)disiplinë e re dhe premtuese akademike: tranzitologjia. Në të vërtetë, zhvillimi dhe synimi i kësaj literature të re që po dilte gjithnjë e më shumë në pah nuk ishte dhe aq modest në vetvete, pasi nuk limitohej vetëm në përpjekjen për të kuptuar apo shpjeguar ngjarjet, proceset apo fenomenet e ndryshme të cilat po zhvilloheshin gjatë kohës së cilës po flasim. Synimi i tyre shkonte më tej se kaq. Të orientuara më së tepërmi drejt qëllimit (dëshira për të parë demokracinë të triumfante në ato vende që sapo kishin dalë nga regjimet autoritare apo totalitare), si dhe duke theksuar se nuk kishte nevojë për parakushte të veçanta për demokratizimin, synimi i këtyre studimeve e reja tranzitologjike që po shfaqeshin ishte praktikisht që ato edhe të ktheheshin në udhërrëfyes të suksesshëm për vendet e reja që po kërkonin të demokratizoheshin. Megjithatë, me shtrirjen konceptuale të këtij modeli të tranzicionit edhe me vendet që përfshinë më vonë në atë ashtuquajturën valë të tretë të demokratizimit, u shfaqën edhe të metat dhe problemet e para të kësaj paradigme. Në këtë punim synohet të bëhet një kritikë ndaj telos-it që karakterizon kryesisht qasjen e tranzitologjisë, si dhe të kuptojë nëse konceptet dhe supozimet bazë teorike të kësaj qasjeje na ndihmojnë ose jo në kuptimin e proceseve të demokratizimit në vende të ndryshme.

2. Konceptet dhe supozimet bazë të tranzitologjisë

Kuadri konceptual që ofrojnë tranzitologjistët për lindjen e demokracive të reja dhe shpjegimin e proceseve të demokratizimit në vende të ndryshme, sfidonte hapur studimet e mëparshme mbizotëruese të demokratizimit. Këto studime në fjalë, deri atëherë bazoheshin kryesisht në qasjet strukturaliste apo ato modernizuese të cilat e shihnin lindjen dhe zhvillimin e demokracisë si një proces të ngadaltë dhe evolucionar dhe që kërkonte përmbushjen e disa parakushteve më parë. Kështu, modeli që propozojnë tranzitologjistët nuk fokusohet më tek faktorët funksionalë apo strukturorë, por përkundrazi ai e “braktis kërkimin e “parakushteve funksionale” për demokracinë”. Një pohim të tillë duket se bën pak vite më pas nga Dankwart Rustow, edhe Juan Linz, një nga baballarët më vonë të tranzitologjisë dhe konsolidologjisë, kur deklaronte se “dinamika e vërtetë e proceseve politike duhet të kërkohej tek zgjedhjet e bëra nga aktorët politikë dhe jo tek strukturat sociale”. Në këtë kontekst bashkë me demokratizimet e papritura dhe relativisht të suksesshme të Spanjës, Portugalisë, Greqisë dhe pak vendeve në Amerikën Latine, edhe vepra kryesore kryesore e tranzitologjisë me bashkautorë Guillermo O'Donnell dhe Philippe C. Schmitter, do të deklaronte se nuk ishin të nevojshme parakushte për demokratizimin, duke u fokusuar kështu ekskluzivisht mbi variabilet shkakësorë të agjentit (elitave, aktorëve politikë). Një qasje e tillë që po lindte duket se ishte dhe mjaft tërheqëse për t'u adoptuar dhe për të shpjeguar atë që shumë veta në atë kohë e konsideronin “revolucion demokratik mbarë botëror”, ku në kulmin e valës së tretë më shumë se 50 vende kishin përmbysur regjimet e tyre të mëparshme autoritare. Tranzitologjistët argumentonin se tranzicionet nga regjimet autoritare drejt demokracisë vareshin shumë më pak nga nivelet e zhvillimit dhe modernizimit të një vendi se sa nga se sa zgjedhjet kontingjente dhe strategjike të aktorëve politikë të përfshirë në këtë proces. Kështu duke ndjekur punën pioniere të autorëve si Dankwart Rustow, Guillermo O'Donnell dhe Philippe C. Schmitter, më vonë edhe autorë të tjerë të qasjes së tranzitologjisë do të eksploronin më vonë nocionin thelbësor se demokratizimi është produkt i kontingjencës dhe zgjedhjes, bazuar mbi vendimet e aktorëve që kërkojnë ta lundrojnë paqartësinë midis regjimit të vjetër dhe sistemit të ri të negociuar (demokracisë). Në këtë mënyrë, duke anashkaluar pa shumë shqetësim problemet strukturore me të cilat mund të përballeshin regjimet e reja në rrugën e tyre drejt demokratizimit, qasja e re e tranzitologjisë nxirrte në plan të parë ndërveprimin strategjik dhe të ndërgjegjshëm midis elitave si faktor kyç për demokratizimin. Këto elita, edhe pse mund të vepronin në një proces kompleks dhe të vështirë, prapë se prapë ishin të afta ta lundronin me sukses regjimin drejt vendosjes së demokracisë pavarësisht kontekstit strukturor të vende të tyre. Tranzicionet (drejt demokracisë) përfaqësojnë një zgjedhje eksplicite nga sektorët vendimtarë të komunitetit politik të cilët kërkojnë dhe mobilizojnë për një tranzicion drejt demokracisë ndërkohë që kontrollin institucionale mund të ndryshojnë.

Një nga supozimet bazë të tranzitologjisë, që siç edhe Thomas Carothers e ka cilësuar si më gjithëpërfshirësi dhe si një ombrellë për supozimet e tjera, është se çdo vend që largohet nga një qeverisje diktatoriale mund të konsiderohet një vend në tranzicion drejt demokracisë. Duke u bazuar tek kjo strukturë konceptuale e qasjes së tranzitologjisë, analistë, promovues të ndryshëm të demokracisë, por edhe akademikë, nisën t'i trajtonin dhe shpjegonin tendencat e ndryshimeve politike që ndodhnin në vende të ndryshme të globit si pjesë apo hapa që hidheshin drejt kalimit për në demokraci. Kështu duke e anashkaluar apo duke u përballur pa shumë problem me çështjen e “shtrirjes konceptuale” të saj, për ato që e përqafuan shpejt këtë qasje të tranzitologjisë dhe filluan të shihnin çdo tendencë ndryshimi politik nëpërmjet lenteve të saj, praktikisht të gjitha vendet e botës e gëzojnë të drejtën e etiketimit si “vende në tranzicion” drejt demokracisë.

Një supozim tjetër i rëndësishëm i qasjes së tranzitologjisë është se demokratizimi priret të ndjekë apo të shpalojë nëpërmjet asaj që njihet si modeli i tranzicionit që konsiston në tre faza. Në fazën e parë ndodh hapja, një periudhë fermentimi demokratik dhe liberalizimi politik në të cili ndarjet shfaqen brenda regjimit sundues diktatorial, me linjën më të spikatur që

është ajo midis hardliners dhe softliners . Më pas në fazën e dytë, ndjek një thyerje (breakthrough) në regjimin e vjetër, një moment kur kemi edhe kolapsin e tij si dhe daljen e sistemit të ri demokratik: shfaqjen e pluralizmit politik, formimin ose ringjalljen e shoqërisë civile, si dhe shpalljen/mbajtjen e zgjedhjeve ku rezultati i të cilave është i paqartë (uncertain outcome) . Mbjajtja e atyre që njihen edhe si zgjedhjet themeluese të regjimit të ri, si dhe pranimi i rezultateve të tyre të paqarta thuhet se shënojnë edhe fundin e tranzicionit nga sundimi autoritar dhe vendosjen e qeverisjes demokratike. Konceptualisht, siç edhe Guillermo O'Donnell e ka bërë dallimin më vonë, ne kemi të bëjmë me dy tranzicione: njëri është tranzicioni drejt demokracisë (ai drejt vendosjes së një qeverisje të zgjedhur demokratike, faza e dytë këtu), ndërsa tjetri është tranzicioni drejt një regjimi demokratik të institucionalizuar, të konsoliduar . Pikërisht konsolidimi i demokracisë përbën edhe fazën e tretë sipas këtij modeli, që i referohet atij procesi në të cilën demokracia dhe kuadri i saj institucional përbëjnë kornizën e vetme të rregullave të lojës për (të gjithë) shoqërinë, dhe ku aktorët e saj të ndryshëm politik dhe shoqëria në tërësi mësohen, i përshtaten dhe luajnë konform tyre etj.

Një presupozim i katërt që rrjedh prej paradigmës së tranzicionit, i lidhur deri diku edhe me idenë e shpalesjes së demokratizimit në faza apo sekuenca, është ai i besimit mbi rëndësinë vendimtare që kanë zgjedhjet për rrugën e demokratizimit të vendeve që dalin nga regjime autoritare/diktatoriale. Kështu Thomas Carothers argumenton se ndërsa promovuesit e ndryshëm të demokracisë kanë besuar në vënien e shenjës e barazisë midis zgjedhjeve dhe demokracisë, ato kanë pasur edhe pritshmëri të larta në lidhje me mbajtjen dhe zhvillimin e zgjedhjeve të drejta e të rregullta, duke besuar se ato do të shërbenin për forcimin dhe konsolidimin e institucioneve demokratike të një vendi, do të zgjeronin dhe thellonin pjesëmarrjen politike si dhe llogaridhënien demokratike të shtetit ndaj qytetarëve . Siç edhe Rose dhe Shin kanë vërejtur, studime të ndryshme në pikën e valës së tretë të demokratizimit arritën deri aty sa të trajtonin institucionalizimin e konkurrimit elektoral si të mjaftueshëm për të konsoliduar demokracinë .

Një presupozim i fundit, por jo më pak i rëndësishëm që mund të kuptohet prej një pjese të mirë të literaturës së tranzicionit është ai sipas të cilit mënyrat e tranzicionit nga sundimi autoritar kanë ndikime të rëndësishme mbi stabilitetin, modelimin, si dhe në perspektivat e konsolidimit të regjimeve (të presupozuara demokratike) të reja. Në veçanti, kjo literaturë mbi mënyrat e ndryshme të tranzicionit e vendos theksin mbi rëndësinë që kanë paktet midis elitave si dhe forma të tjera konsensusit midis tyre që konsiderohen se janë të favorshme dhe nxitëse për procesin pasues të demokratizimit në një vend. Një pakt mund të përkufizohet si një marrëveshje eksplicite, por jo gjithmonë e shtjelluar apo e justifikuar publikisht, ndërmjet një grupi të caktuar aktorësh të cilët kërkojnë të përcaktojnë (ose, më saktë, të ripërcaktojnë) rregullat që rregullojnë ushtrimin e pushtetit mbi bazën e garancive të përbashkëta për “interesat jetësorë” të atyre që hyjnë në to . Paktet apo marrëveshjet midis aktorëve të ndryshëm politikë që udhëheqin procesin e tranzicionit shihen si të rëndësishme për të shmangur rezultatet e padëshiruara (dhunën, revoltat me pasoja nga masat e mobilizuara), reduktojnë kontingjencën dhe paqartësinë e qenësishme që karakterizojnë një proces të tillë dinamik, shpërndajnë përfitimet në mënyrë përpjestimore midis aktorëve politikë në lojë, si dhe mbi të gjitha garantojnë “interesat jetësorë” (mos përfshirimin nga skena politike) të gjithsecilit: atyre që janë në pushtet dhe sfiduesve në opozitë. Një elementi të tillë në qasjen e tranzitologjisë, shpesh autorë të ndryshëm i janë referuar si “paktologji”, nocioni se liderët autoritarë dhe opozita demokratike duhet të bëjnë pakte për mbrojtje reciproke përpara se demokracia të mund të vazhdojë . Negocimet, përpjekjet për ujdi si dhe marrëveshjet midis palëve shihen si qendrore në gdhendjen e demokracisë.

3. Një kritikë anti-teleologjike ndaj përgjithësimeve teorike të qasjes së tranzitologjisë

Nëpërmjet atyre që kemi shtjelluar deri më tani si konceptet dhe kryesore të qasjes së tranzitologjisë, tranzitologjistët kanë pretenduar jo vetëm të shpjegojnë por edhe të ndihmojnë vendet të ndryshme duke udhëzuar rrugën e ndryshimit të regjimit nga ai autoritar / totalitar në atë demokratik. Ndërsa veprat më të hershme të tranzitologjisë që i kemi përmendur tashmë, u përqendruan dhe u përpoqën të nxirrin konkluzione duke u bazuar kryesisht mbi eksperiencën gati ex post facto të disa vendeve që kishin arritur të kryenin tranzicione të suksesshme regjimi në fundin e viteve '70 dhe vitet '80 (me Spanjën si rastin kryesor paradigmatic), tranzitologjistët e mëvonshëm menduan ta shtrinin (dhe ta zhvillonin më tej) kuadrin konceptual të paradigmës së tranzicionit edhe me vende që mund të thuhet se nuk u imagjinuan kurrë fillimisht. Kështu, tranzitologjistët pretenduan se kuadri konceptual i zhvilluar në Europën Jugore dhe Amerikën Latine ishte i vlefshëm edhe për Europën Lindore dhe rajone të tjera gjeografike të botës, pasi “duke u mbështetur tek një grup konceptesh, presupozimesh dhe hipotezash universale, është e mundur të shpjegohen dhe madje edhe të drejtohen ndryshimet nga regjimet autokratike drejt atyre demokratike” . Megjithatë, një pretendim i tillë duket se nuk qëndron më në ditët e sotme, dhe se modeli i zhvilluar nga tranzitologjistët dhe konsolidologët nuk vlen më për të shpjeguar realitetin politik të shumë prej atyre vendeve në rajone të ndryshme të botës, të cilët edhe pse të çliruara nga regjime autoritare / totalitare gjatë të ashtu njohurës valë e tretë e demokratizimit e më tej, nuk kanë arritur (dhe duket se as nuk do të arrijnë për një kohë mjaft të gjatë) drejt vendosjes apo institucionalizimit të plotë të demokracisë. Pra, thënë me fjalë të tjera, se kuadri konceptual i paradigmës së tranzicionit nuk vlen për të shpjeguar procesin e demokratizimit drejt së cilës presupozohej se po shkonin këto vende. 25 vite pas rënies së murit të Berlinit dhe kolapsit të Bashkimit Sovjetik, që shënonte edhe kulmin e të ashtuquajturës vala e tretë, literature e tranzicionit nuk është më e aplikueshme për të kuptuar zhvillimet politike në shumë shtete dhe rajone të ndryshme të botës sot.

Kritika më e madhe që i adresohet qasjes së tranzitologjisë këtu është se një qasje e tillë në thelb të saj karakterizohet nga një dimension dhe tendencë e fortë teleologjike në vetvete, duke ndërtuar kështu modele shpjeguese për demokratizimin që janë të orientuara më së tepërmi drejt telos-it (qëllimit) dhe që anashkalojnë të kuptuarin e kompleksitetit dhe specifikave të veçanta të

këtij procesi në vende të caktuara. Kështu, duke u përqendruar më së tepërmi drejt qëllimit – që në këtë rast është zhvendosja e shoqërive që dalin nga regjime autoritare drejt modelit të demokracisë liberale – tranzitologjistët janë përpjekur të parashtrorjnë edhe fazat konkrete nëpër të cilat demokratizimi shihet të kalojë, duke e shpjeguar atë si një proces që ecën (thuaje) në mënyrë racionale dhe pa i kushtuar shumë vëmendje specifikave të veçanta të kontekstit të secilit vend (kujtoni më lart autorët tranzitologjistë: gjeografia dhe kultura politike nuk kanë më rëndësi; faktorët strukturorë “makro” nuk janë dhe aq përcaktues). Ndryshe nga qasjet e tjera në lidhje me demokratizimin, dimensionin teleologjik është akoma më i dallueshëm në qasjen tranzitologjike, e cila pothuajse e injoron trashëgiminë historike dhe sociale duke parashtruar fazat konkrete nëpër të cilët aktorët politikë duhet të kalojnë për ta zhvendosur një vend nga autoritarizmi drejt një modeli të caktuar të liberal demokracisë. Një qasje tillë pra, prirret t’i shpjegojë ndryshimet apo transformimet politike thujtë në terma të një procesi racional, i cili në mënyrë progresive e të vazhdueshme shkon drejt një rezultati fundor teleologjikisht të paracaktuar dhe të dëshiruar: që në këtë rast është konsolidimi i demokracisë në një vend të caktuar. Siç e kemi përmendur dhe më lart në këtë punim, një kritikë të tillë ndaj kësaj qasje e ka pohuar edhe vetë një prej themeluesve kryesorë të saj, Guillermo O’Donnell, i cili e pranon se ka pasur një tendencë të fortë teleologjike përgjatë kësaj literature (të tranzicionit dhe konsolidimit të demokracisë)”. Qasja e tranzitologjisë, përveç se mund të kritikohet si vullnetariste në interpretimin e saj që gati shkon edhe përtej një logjike normative, është edhe e gabuar dhe e paaftë për të na ndihmuar të kuptojmë zhvillimet politike në shumë prej vendeve të valës së tretë, të cilat edhe pse u çliruan nga regjime autoritare gjatë periudhës në fjalë nuk kanë shkuar drejt demokracisë. Në fakt, eksperiencia e përjetuar e shumë prej këtyre vendeve ka treguar se demokratizimi (ashtu si edhe procese të tjera sociale në përgjithësi) rrallë mund të shpjegohet në terma të një procesi që ecën në mënyrë lineare racionale apo edhe natyrale siç pretendojnë disa tranzitologjistët, dhe se ai është shumë më tepër kompleks në vetvete duke përfshirë një shumësi faktorësh (strukturorë, socialë, historikë) që ndikojnë në rezultatin e tij.

Mbizotërimi i regjimeve autoritare apo gjysmë-autoritare (regjimet hibride) në shumë vende të valës së tretë, por edhe gjendja e “jo konsolidimit të zgjatur” të shumë të tjerave prej tyre e ka ngatërruar dhe, shpesh madje edhe, hedhur poshtë telos-in e demokratizimit të paradigmës së tranzicionit. Kështu, alternativa një drejtimore - “në tranzicion drejt demokracisë”

– që kjo qasje nënkupton nuk është e saktë dhe nuk përputhet me realitetin politik që ajo përpiqet të shpjegojë. Zhvillimet politike apo drejtimet e ndryshme që një pjesë e mirë e këtyre vendeve të valës së tretë kanë marrë gjatë fundit të shek. XX dhe fillimit të shekullit XXI, kanë treguar se ndryshimi i regjimit ka qenë (dhe është) krejt ndryshe nga ai të qenurit një proces teleologjik. Një realitet i tillë i regjimeve politike të këtyre vendeve të valës së tretë tregon se është jo vetëm shumë më tepër kompleks në vetvete duke prodhuar variacione të ndryshme regjimesh (madje që kanë qenë edhe të qëndrueshme, për një kohë relativisht të gjatë tashmë), por edhe që e ka hedhur poshtë idenë e një “progresi natyral” të orientimit të tyre drejt demokracisë. Siç edhe Steven Levitsky dhe Lucan Way kanë vërejtur: “Megjithëse disa regjime hibride (Meksika Senegali, Taivani) iu nënshtuan tranzicioneve demokratike gjatë viteve ’90, të tjera (Azerbajxhani, Bjellorusia) lëvizën në një drejtim të dallueshëm autoritar. Përsëri të tjera ose mbeten të qëndrueshme ose lëvizën në drejtime të shumëfishta (Malajzia, Rusia, Ukraina, Zambia, Zimbabve), duke i bërë nënkuptimet një drejtimore të botës “tranzicionale” çorientuese”.

Po kështu, edhe po t’i referohemi numërimit të bërë nga Barbara Geddes mbi regjimet politike, “nga tetëdhjetë e pesë regjime autoritare që u rrëzuan gjatë të ashtuquajturës valë e tretë e demokratizimit, tridhjetë e katër rezultuan në diktatura të reja, tetë rezultuan në regjime mikse, dhe katër përfunduan në luftë”. Pra, autorët theksojnë drejtimet e ndryshme dhe alternative që zhvillimet e regjimeve mund të marrin, duke e bërë në këtë mënyrë të pakuptimtë gjuhën tranzicionale që nënkupton ndryshimin e drejtuar të këtyre vendeve drejt (ose larg) demokracisë. Një gjë të tillë ka argumentuar edhe Thomas Carothers kur vë në dukje se: “Për disa vite tashmë, ka qenë e qartë se një numër i madh i regjimeve të reja nuk janë në vetvete demokratike, dhe as më “në tranzicion” drejt demokracisë... Edhe pse modelet më të zakonshme politike të disa prej këtyre vendeve përfshijnë elementë të demokracisë, ato duhen kuptuar si drejtime alternative, dhe jo si stacione në rrugën drejt demokracisë liberale”. Zhvillimet politike në këto regjime, të cilat edhe pse lejojnë shprehjen e pluralizmit dhe hapësira për partitë opozitare dhe shoqërinë civile i thyejnë vazhdimisht në parimet dhe procedurat e demokracisë mjediset e tyre, e vë në dyshim të madh implikimin e këtij supozimi të parë dhe në thelb edhe të vetë paradigmës së tranzicionit, se ato janë në rrugën e tyre drejt demokracisë. Është bërë gjithnjë e më e qartë tashmë se shumë nga këto regjime nuk janë më “në tranzicion” nga një regjim në tjetrin por përdorin mekanizma selektivë të demokracisë për të krijuar “zona gri” të institucionalizuara. Kjo përbën edhe kushtin më të përhapur në të cilat ndodhen një pjesë e mirë e regjimeve të vendeve të valës së tretë, me modele politike që përfshijnë kufizime të shumta (zakonisht informale) në mënyrën e funksionimit të rregullave të demokracisë dhe thyerje të tyre, dhe që janë bërë tashmë një tipar i rregullt apo edhe i ngulitur i tyre.

4. Dy aspekte problematike metodologjike të qasjes së tranzitologjisë

Paafësia e literaturës së tranzitologjisë për të shpjeguar apo hedhur dritë mbi shpjegimet komplekse të demokratizimit vjen edhe si pasojë e kombinimit të dy faktorëve metodologjikë. Së pari, kjo literaturë fokusohet tek shpjegimi i proceseve të demokratizimit në raport me një teori të dhënë, më shumë se sa tek kuptimi i tyre brenda kontekstit ku këto zhvillime ndodhin. Tranzitologjia nuk i merr parasysh dallimet e ndryshme si dhe të qenësishme që ekzistojnë midis vendeve apo rajoneve të ndryshme të botës në pretendimin e saj e të qenurit një model universal në shpjegimin e demokratizimit. Kështu, edhe autorët e kësaj qasje të tranzitologjisë shpjegimet e tyre i bazojnë mbi modele të përgjithshme apo universale (brenda paradigmës), dhe jo tek karakteristikat apo shpjegimet e veçanta të rasteve. Në fakt, pyetje të tilla si “çfarë është duke ndodhur në një vend të caktuar”, apo “cilat janë specifikat e veçanta që lehtësojnë apo e pengojnë një vend në rrugën e tij drejt demokratizimit”

nuk shtrohen kurrë dhe nuk janë tipike për këtë qasje, duke neglizhuar në këtë mënyrë faktorë të rëndësishëm shpjegues që përfshijnë variabile të shumëfishtë dhe që në një pjesë të mirë të tyre duhen kuptuar në funksion të dinamikave të konteksteve të veçanta ku ato ndodhin. P.sh. për të kuptuar zhvillimin e shpejtë dhe të suksesshëm të Spanjës drejt demokracisë në vitet '70 (kujtoni, rasti paradigmatic që tranzitologjistët marrin si shembull në qasjen për shpjegimin e demokratizimit) në krahasim me ato të fjala bie Rusisë apo Shqipërisë post-komuniste, duhet të kihet parasysh konteksti shumë më i favorshëm shumë planësh në të cilën ndodhej Spanja në periudhën e pas vdekjes së Frankos: me një shoqëri shumë më të hapur dhe pluraliste, me një kulturë politike që kishte kohë që transformohej dhe i përshtatej edhe atyre të shoqërive më të përparuara europiane në atë kohë, me një ekonomi thaujse të pacenuar që madje kishte njohur edhe rritje të konsiderueshme gjatë periudhës së Frankos, me një trashëgimi institucionale gjithashtu thaujse të pacenuar dhe një shoqëri civile të zhvilluar etj. Të gjitha këto në rastin e shoqërive post-totalitare ruse apo shqiptare në fillimin e viteve '90 është pak të thuhej se nuk ekzistonin dhe ku konteksti ku demokratizimi po ndodhte ishte krejt i ndryshëm. Këtu, nuk është as e rastit që ndër kritikët më të mëdhenj të qasjes së tranzitologjisë dhe të demokratizimit të krahasuar në përgjithësi janë pikërisht ekspertët e “studimeve të zonës” (area studies), për të cilët tranzitologjistët jo vetëm bënin gabimin e neglizhimit e faktorëve strukturorë apo socialë që ndikojnë në proceset e demokratizimit, por edhe sepse ata injoronin specifikat e veçanta apo diferencat thelbësore të konteksteve të ndryshme të demokratizimit në Europën Jugore me ato të Europës Lindore (vendet post-komuniste). Kështu, ndërsa tranzitologjistët injorojnë kontekstin specifik të secilit vend apo rajon, ato “e shohin atë edhe si diçka që duhet tejkaluar për t'i vendosur dukuritë apo zhvillimet politike në fjalë (demokratizimin në këtë rast) në një kuadër teorik universal. Për pasojë, ky kontekst jo vetëm nuk merret parasysh por anashkalohet si një rrethanë që në fakt fsheh vetë thelbin e problemit”, duke neglizhuar në këtë mënyrë specifika të veçanta apo edhe faktorë të rëndësishëm shpjegues që do na ndihmonin të kuptonin mbi ndodhjen apo vazhdimësinë e fenomene të caktuara negative në vende të ndryshme.

Këtu mund të vijmë edhe tek faktori i dytë metodologjik i qasjeve të demokratizimit, ku bën pjesë edhe tranzitologjia: për sa kohë theksi është tek shpjegimi i universales dhe jo kuptimi i lokales, fokusi metodologjik do zhvendoset nga niveli mikro në atë makro. Pra, niveli makro ka prirje të theksohet në kurriz të kuptimeve apo zhvillimeve në nivel mikro. Neglizhimi i nivelit mikro në këto qasje që strukturën e tyre konceptuale e kanë të bazuar te dimensionin makro është përsëri problematik në shpjegimin e proceseve të demokratizimit në vende të caktuara, pasi edhe në këtë rast anashkalohen rrethana apo faktorë të veçantë politiko-sociale të secilit vend që mund të shpjegojnë dhe që, në fund të fundit, mund të argumentohet edhe se i sendërtojnë sjellje, problematika apo dukuri të caktuara. Neglizhenca e nivelit mikro në disiplinën e demokratizimit është kritikuar shpesh dhe veçanërisht nga qasjet etnografike dhe antropologjike, sidomos nga Katherine Verdery. Në përshkrimet konvencionale “të tranzicionit” niveli mikro përcaktohet nga, ose është një shprehje e strukturave, politikave dhe ideologjive të një niveli makro, duke neglizhuar teorizimin e pasojave të paqëllimshme në nivel lokal, si pasojë e kontestimeve kulturore dhe politike”. Pra, dukuritë dhe zhvillimet politikë nuk përcaktohen apo mund të kuptohen vetëm në nivel makro sipas ligjësisve universale, por një fokus tek dimensionin mikro, tek faktorë të tjerë në nivel mikro dhe rrethanat specifike politike të secilit vend, është gjithashtu i nevojshëm në analizimin dhe kuptimin e tyre.

5. Konkluzione

Përmbysjet politike që përfshijnë vende të ndryshme të botës përgjatë dy dekadave të fundit të shekullit të njëzetë, kanë treguar se transformimi i regjimit të tyre drejt vendosjes së një demokracie liberale dhe mirë funksionuese nuk është aspak një proces teleologjik. Nga këtu, dhe me një pikëpamje të tillë teleologjike që e ka karakterizuar më së shumti zhvillimin dhe lulëzimin e literaturës së saj që nga fillimet e veta, duhet kuptuar edhe qasja e tranzitologjisë dhe kuadri konceptual që ajo ofronte për shpjegimin e proceseve të demokratizimit të këtyre vendeve. Është bërë e qartë tashmë në nivel empirik se realiteti politik i shumë prej vendeve të valës së tretë që u çliruan nga përvoja të mëparshme autoritare/totalitare nuk i përgjigjej aspak pritshmërive dhe supozimeve të paradigmes së tranzicionit, si dhe me shfaqjen e regjimeve të reja në mjediset e tyre që morën drejtme të ndryshme dhe që kjo qasje e tranzitologjisë dështoi t'i shpjegonte. Prej shumë kohësh tashmë është bërë gjithnjë e qartë se kuadri konceptual i paradigmes së tranzicionit është i papërshtatshëm për të kuptuar kushtet apo zhvillimet politike në shumë prej vendeve të valës së tretë, si dhe me supozimet e saj që nuk janë më të vlefshme në konceptualizimin e demokratizimit (drejt së cilës presupozohej se do shkonin këto vende) dhe që nuk gjejnë zbatueshmëri në terrenin empirik që ato përpiqen të shpjegojnë.

Qasja e tranzitologjisë, përtej vizionit shpresëdhënës së saj, ka dështuar në shpjegimin e zhvillimeve të ndryshme politike që kanë ndodhur (dhe ndodhin) në shumë vende të valës së tretë, dhe aq më tepër në pretendimin e saj për të ndryshuar drejtimin e këtyre proceseve drejt institucionalizimit të një regjimi demokratik apo “konsolidimit” të demokracisë në mjediset e tyre. Vazhdimi i theksimit apo i aplikimit të këtyre supozimeve, koncepteve dhe hipotezave të paradigmes së tranzicionit ndaj vendeve që kanë kaluar edhe çerek shekulli pa shkuar drejt “konsolidimit” të demokracisë së tyre, apo edhe ndaj vendeve që fare pak kanë të bëjnë me demokracinë (si Afganistani, Burma etj. në ditët e sotme) duket më tepër si përpjekje për të ndrequr faktet që t'i përshtaten teorisë. Në fakt, metoda shkencore në politikën e krahasuar do të thotë se nuk materializojmë kuadrot tona konceptuale: ne ndreqim, ndryshojmë, testojmë apo edhe zhvlerësojmë teoritë tona përballë fakteve, përballë realitetit. E kundërta thjesht nuk mund të ndodhë. Paradigma e tranzicionit ka treguar prej shumë kohësh tashmë se nuk i përshtatet realitetit (fenomenit) që ajo përpiqet të shpjegojë. Debate dhe lëvizje në korniza të reja, si dhe një konceptim tjetër në studimin e demokratizimit, që sigurisht nuk injoron kontekstin dhe specifikat e veçanta të secilit vend ku demokracia kërkohet të zhvillohet, na duhen.

Bibliografia

- Bunce, Valerie (1991), "Should Transitologists be Grounded". *Slavic Review*, Vol. 54, No. 1, fq. 111-127.
- Buraway M. & Verdery K. edit. (1999), "Uncertain Transitions: Ethnographies of Change in the Postsocialist World". New York: Rowman & Littlefield Publishers.
- Carothers, Thomas (2002), "The End of the Transition Paradigm". *Journal of Democracy*, Volume 13, Number 1, fq. 5-21.
- Diamond, Larry & Fukuyama, Francis & Horowitz, Donald L. dhe Plattner, Marc F. (2014), "Reconsidering the "Transition Paradigm". *Journal of Democracy*. Vol. 25, No. 1.
- Geddes, Barbara (1999), "What Do We Know About Democratization After Twenty Years?". *Annual Review of Political Science* 2, fq. 115-144.
- Huntigton, Samuel (2011), "Vala e Tretë – Demokratizimi në fund të shekullit të njëzetë". Tiranë: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare. (Botimi origjinal i veprës është viti 1991).
- Kajsiu, Blendi (2007), "Demokratizim pa Politikë: Baza Konceptuale e Qasjes Ndërkombëtare në Shqipëri". Tiranë: Revista Polis, Numër 4, fq. 23-38.
- Karl, Terry Lynn (2005), "From Democracy to Democratization and Back: Before Transitions from Authoritarian Rule". Stanford: Center on Democracy, Development and The Rule of Law, Number 45.
- Levitsky, Steven and Lucan A. Way (2002), "The Rise of Competitive Authoritarianism". *Journal of Democracy*, Vol. 13. No. 2, fq. 51-65.
- Linz, Juan J. and Alfred Stepan (1996), "Problem of Democratic Transition and Consolidation". Baltimore: John Hopkins University Press.
- Mohamedou, Mohammad-Mahmoud Ould & Sisk, Timothy D. (2013). "Bringing Back Transitology: Democratisation in the 21st Century". Gesp Geneva Papers, Research Series No 13.
- O'Donnell, Guillermo (1994), "Delegative Democracy". *Journal of Democracy*, Vol. 5, No. 1, fq. 55-69.
- O'Donnell, Guillermo, (1996), "Illusions About Consolidation". *Journal of Democracy*, Volume 7, No. 2, fq. 34-51.
- O'Donnell, Guillermo and Philippe Schmitter (1986), "Transitions from Authoritarian Rule: Tentative Conclusions about Uncertain Democracies" Baltimore: John Hopkins University Press.
- Rose, Richard and Shin, Doh Chull (2001), "Democratization Backwards: The Problem of Third-Wave Democracies". *British Journal of Political Science*, Vol. 31, No. 2, fq. 331-354.
- Rustow, Dankwart (1970), "Transitions to Democracy: Toward a Dynamic Model". *Comparative Politics*, Vol. 2, No. 3, fq. 337-363.
- Schedler, Andreas (2001), "Taking Uncertainty Seriously: The Blurred Boundaries of Democratic Transition and Consolidation". *Democratization* Vol 8, No. 4, fq.1-22.
- Schmitter, Philippe C. and Terry Lynn Karl (1994), "The Conceptual Travels of Transitologists and Consolidologists: How Far to the East Should They Attempt to Go?". *Slavic Review*, Vol. 53, No. 1, fq. 173-185.
- Wierda, Howard J. (2001), "Southern Europe, Eastern Europe and Comparative Politics: "Transitology" and the Need for New Theory". Sage Publications, *East European Politics and Societies* Volume 15, Number 4, fq. 485-501.

PASOJAT E KOMUNIZMIT NË KULTURËN POLITIKE SHQIPTARE

DR. INA K. ZHUPA

UET, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit

ABSTRAKT

Kultura politike e një vendi ka si dimension kryesor dhe si palcën e vet integrale vlerat që mbart ai vend. Ronald Inglehart në studimet e tij mbi vlerat ka tezën që vendet që kanë kaluar komunizmin, siç janë ato të Europës Juglindore do të kenë ngjashmëri në vlera dhe në kulturën politike rrjedhimisht për hir të kësaj periudhe të karakterizuar nga mungesa të theksuara. Në këtë punim tentohet të kuptohet se cilat janë konkretisht dimensionet vlerësuese, dhe në sjellje konkrete që mund të shpjegohen në kulturën tonë politike si rrjedhojë e sistemit 50 vjeçar komunist. Shqipëria ishte dhe mbeti i vetmi vend i Europës Juglindore që evitoi çdo lloj mendimi revizionist dhe u qëndroi presioneve për hapjen dhe liberalizimin e shoqërisë, përshirë edhe ato të tipit gllasnost apo perestrojka në gjysmën e dytë të viteve 1980, të cilat ndikuan në zhvillimin e vendeve të tjera ish-komuniste. Kultura politike është manifestimi në formë agregate e dimensioneve psikologjike dhe subjektive të politikës. Produkti i gjithë historisë së një sistemi politik dhe historisë së anëtarëve të sistemit. Në këtë këndvështrim është e pamundur që një periudhë aq e gjatë qeverisje si komunizmi të mos lërë pasojë në kulturën politike që reflektohen edhe 26 vjet më pas në demokracinë e brishtë shqiptare. Do të jepet një analizë të dimensioneve kulturore, ekonomike, shoqërore që marrim nga literaturë në mënyrë të tillë që të bëjmë një radiografi të aspekteve të ndërtimit të komunizmit. Së fundmi do jemi në gjendje të krijojmë një pasqyrë të trashëgimisë së komunizmit në kulturën tonë politike që mund të na shpjegoj shumë nga fenomenet që ndodhin sot në jetën politike dhe sociale të vendit.

Fjalë kyç: *kulturë politike, trashëgimia komuniste, vlerat kulturore, besim social.*

Hyrje

Kultura politike i jep rëndësi qëndrimeve politike, besimeve, vlerave dhe emocioneve në shpjegimin e fenomeneve politike, strukturore dhe të sjelljes, kohezionin nacional, modele të copëtimeve politike, modele të përballuarit të konfliktit politik, niveli dhe karakteri i pjesëmarrjes në politikë dhe pajtimi me autoritetin (Almond, 1956). Kultura politike është gjithashtu sistemi i besimeve empirike, simboleve të shprehura dhe vlerave të cilat përcaktojnë situatën në të cilën aksioni politik zhvillohet (Wilson, 2010). Që do të thotë se kultura politike është manifestimi në formë agregate e dimensioneve psikologjike dhe subjektive të politikës. Produkti i gjithë historisë së një sistemi politik dhe historisë së anëtarëve të sistemit. Në këtë këndvështrim është e pamundur që një periudhë aq e gjatë qeverisje si komunizmi të mos lërë pasojë në kulturën politike që reflektohen edhe 26 vjet më pas në demokracinë e brishtë shqiptare. Sipas Fatos Tarifës, duke ju referuar O'Donnell dhe Schmitter(1991:30), është e vështirë të përfytyrohet se si një shoqëri mund të rikthehet në një shkallë të caktuar normaliteti, e cila do të mundësonte mbështetje sociale dhe ideologjike për demokracinë politike, pa u marrë me disa nga elementet më të dhimbshme të së kaluarës së saj. (Tarifa,2009)

Metodologji

Ky është një punim teorik që kërkon të nxjerr në pah pasojat në kulturën politike të regjimit totalitar komunist në Shqipëri. Për këtë arsye shqyrtimi i literaturës që na vjen nga autorë të huaj dhe shqiptar për këtë çështje të ndryshme që lidhen me kulturën politike ka qenë baza mbi të cilët ngrihet ky punim. Duke u ndarë në dy linja kryesore: linja e parë që lidhet me një dimension në vija të trasha të trashëgimisë komuniste në kulturën politike në të gjitha vendet e Europës JugLindore që e kaluan këtë eksperiencë politiko-social-ekonomike, duke treguar se ku janë pikat që ato mund të bashkohen edhe që janë rrjedhojë e drejtpërdrejtë e sistemit që kishin. Ndërsa linja e dytë kap dimensionin më shqiptar të çështjes së kulturës politike, duke e lidhur me vlera konkrete dhe qëndrime politike konkrete që mungojnë ose shfaqen të deformuara për hir të asaj çfarë komunizmi ka ndërtuar në sistemin e tyre vlerësues dhe kulturor në përgjithësi. Duke u bazuar në këto burime është tentuar që të krijohet një panoramë sa më e plotë dhe koherente duke integruar pjesë të rëndësishme të studiuara nga secili nga autorët sipas fushave të tyre të interesit.

Komunizmi i Europës Juglindore dhe kultura politike

Sipas Ana Volf-Podeska në “Demokracia dhe ekonomia e tregut në Europën Lindore” kultura e re politike e shoqërive post komuniste është një produkt procesesh që po zhvillohen, të paktën në tre dimensione:

- 1- Në dimensionin universal; ku kultura politike shoqërohet me simptomat dhe dukuritë tipike për çdo kthesë me karakter revolucionar .
- 2- Në dimensionin rajonal; ku element i saj integral janë ndryshimet karakteristike për ato shoqëri, të cilat gjenden në rrugën nga komunizmi për në rendin demokratik e të shoqërisë së tregut.
- 3- Në dimensionin e “rrugës së veçantë” ku historia, kushtet gjeopolitike dhe struktura kombëtare e shteteve post-totalitare ndikojnë në atë, që sfidat para të cilave këto shtete gjenden, të kenë një karakter të diferencuar dhe një rreze veprimi të ndryshme. (Volf-Poveska,1995)

“Popujt e ‘vonuar’ të Evropës Qendrore e Lindore, në kundërshtim me ata perëndimore, janë të detyruar që ti kryejnë njëkohësisht proceset e evropianizimit e të rajonalizimit. Formimi i një ndërgjegjeje evropiane, në kushtet e identitetit kombëtar akoma të pa strukturuar, shkakton lindjen e nacionalizmit dhe prirjeve antidemokratike, duke u bërë pengesë në gjetjen e një ekuilibri ndërmjet lojalitetit të qytetarëve ndaj rajonit, shtetit dhe Evropës.” (Ana-Poveska,1995)

Fakti që diktaturat dështuan në arritjen e suksesit ekonomik në vendet e Europës Juglindore, duke qenë edhe faktori kryesor që i çoi në rënie, në presim një pasqyrë pak a shumë të ngjashme të tyre për sa i përket vlerave që mbështesin nivelin dhe cilësinë e demokracisë që kanë instaluar në vend. Po ashtu ekonomia lidhet fort jo vetëm me trashëgiminë e saj në kulturën politike dhe qytetare që ia la komunizmi, por edhe me të ardhmen e demokracisë, “vendet me transformimet më të përparura dhe të suksesshme ekonomike kanë qenë në një njëjtën kohë sistemet me të sigurta dhe efektive demokratike dhe me arritjet më të mëdha në të drejtat politike dhe qytetare” (Krasniqi, 2012:29).

Pavarësisht impaktit shumë të rëndësishme të faktorit ekonomik në klasifikimin e përbashkët të vendeve ish- komuniste, një rol të pamohueshme ka vetë mënyra sesi është i ndërtuar komunizmi dhe si është realizuar ai në këto vende, në të gjitha metodat dhe mjetet e tij për të ndërtuar jetën sociale, morale dhe politike të qytetarëve të vet. Inglehart dhe Baker shprehen se “komunizmi la gjurmë të qartë në sistemin e vlerave të atyre që jetuan në atë sistem” (Inglehart, Baker, 2000:31). Në një studim për tranzicionin politik në Europën Qendrore dhe Lindore, studiuesja Tafili shprehet në lidhje me ndikimin e trashëgimisë perandorake dhe komuniste të këtyre vendeve duke thënë se: “natyra e trashëgimisë perandorake ka ndikim te natyra dhe aftësia e shtetit, ndërsa natyra e trashëgimisë totalitariste ka ndikim tek aftësia e shoqërisë civile. Pra një shtet i efektshëm dhe një shoqëri e gjallë civile janë thelbi i konsolidimit të një autoriteti të qëndrueshëm demokratik” (Tafili, 2008:35).

Tashmë është një fakt i padiskutueshëm se komunizmi i atomizojë shoqëritë europiano lindore, duke shkatërruar pothuajse të gjitha institucionet autonome të veprimtarisë kolektive, të cilave shpesh u referohemi si “shoqëri civile” duke lejuar fare pak hapësirë në sferën publike për çdo lloj forme të iniciativës së lirë private apo të grupit të kishte sukses (Tarifa, 2009:100). Në një analizë që bën për sistemit partiake dhe qeverisëse në Europën Juglindore, studiuesi Krasniqi vë në dukje se: “aspekte të kulturës politike siç janë respekti për tjetrin dhe votën kundër, dialogu konstant e produktiv politik, bashkëpunimi politik parlamentar, pavarësisht raporteve të përfaqësimit, nevoja për institucione të forta në vend, të liderëve të fortë, pjesëmarrja e lartë në zgjedhje apo zgjerimi i rrethit të vendimmarrjes politike- janë dukuri ende të brishta në të gjitha vendet e Europës Juglindore” (Krasniqi, 2012:19).

Aspektet, që përmenden më lart, lidhen në mënyrë të pashmangshme me sistemet e vlerave që kanë qytetarët e këtyre vende dhe detyrimisht edhe elita politike që ka jetuar në një njëjtin mjedis ekonomik dhe social gjatë komunizmit. Të gjitha elementet e mësipërme janë të lidhura me vlerat e vetë afirmimit: tolerancë dhe besim tek tjetri, pjesëmarrje aktive, llogaridhënia dhe kërkimi i llogarisë, marrja pjesë në punët publike. Dëshira për të marrë pjesë në punët publike u mishërua vetëm në elementin e partive politike në këto vende dhe jo në aspekte të tjera të të bërit politikë dhe të qenurit zë pa qenë në politikë. Në përgjithësi, sipas pikëpamjes së studiuesit Attilla Agh: “procesi i formimit të partive në vendet e Europës Lindore dhe Qendrore ka kaluar nga “partitë-lëvizje”, si një organizim-ombrellë në fillimet e veta (solidarnost në Poloni, Forumi Demokratik në Hungari dhe i ngjashëm me këtë të fundit edhe në vende të tjera të Europës Lindore e Qendrore: Forumi Civil në ish Çekoslovakinë, Aleanca e Forcave Demokratike në Bullgari) në parti të plota ose siç është përshkruar më ky proces në “overparticipation” (Kekezi, 2008:46). Po ashtu edhe Shqipërinë mund ta rendisim këtu sepse Partia Demokratike është një parti që rrjedh nga një lëvizje studentësh dhe intelektualësh për liri dhe demokraci, për më shumë të drejta në vitet ‘90 dhe më vonë partitë u shumëfishuan duke kapur shifra rekord për sa i përket raportit parti dhe elektorat, zgjedhës të mundshëm.

Por pavarësisht organizimit në parti politike nga lëvizjet e popullsisë por jo vetëm edhe nga faktorë të tjerë, kjo nuk bëri që qytetari të ishte më në qendër të sistemit dhe të mund të realizonte kërkesat dhe nevojat e tij përmes partive dhe organizimeve politike. “Demokracia u shoqërua me prirjen politike të aktorëve vendimmarrës (sidomos liderëve të partive, shënimi jonë) për ta përdorur lirinë demokratike në funksion të projekteve dhe axhendave të tyre personale” (Krasniqi, 2012:19)

Analiza e pasojave të komunizmit shqiptar në kulturën politike

“Gjatë viteve të regjimit totalitar “mbretëronte” udhëheqja dhe fjala e një individi që shihej si “idhull” nga shqiptarët, falë propagandës ideologjike apo edhe diktatit të vetë shtetit” (Dhima, 2010:198). Studiuesja, Edlira Gjuraj, në punimin e saj në lidhje me kulturën kombëtare në kulturën organizative thotë që: “gjatë viteve të diktaturës mund të themi që pati një theksim të homogjenitetit në termat e përpjekjeve për të njëtrajtësuar punonjësit (qytetarët, shënimi ynë) me figurën e “njeriut të ri”- vepër e partisë së punës dhe për shkatërrimin e besimeve fetare, që nga shkatërrimi i institucioneve të kultit deri në përndjekjen e rreptë të praktikantëve të saj” (Gjuraj, 2013:17).

Në kushtet e një mungese lirie të fesë dhe të jetës kulturore monokulturore, sistemi i vlerave ishte i komanduar dhe i kontrolluar nga një strukturë tepër e përpunuar, kështu shprehet studiuesi Gjergj Sinani, në një vështrim që bën në lidhje me fenë (Sinani, 1999:74). Gjatë komunizmit indoktrimi ishte aspekti kryesor i gërshetuar me jetën sociale të individëve sidomos në aspekte të egalitarizmit, të vullnetarizmit, të rolit të gruas, të mungesës së besimit në institucionet fetare, prirjen drejt progresit industrial dhe më pak shqetësim për mjedisin. “Komunizmi u premtoi njerëzve një parajsë, por jo një parajsë në qiell, por një parajsë në tokë. Shpëtimtari, gati mesiatik, ishte partia, ose për të qenë më të saktë sekretari i parë i Komitetit Qendror të Partisë. Vendin e librave të shenjtë fetarë në Shqipëri e zunë veprat e Enver Hoxhës, që ishte diktatori i shqiptarëve” (Sinani, 1999:74). Studiuesi dhe sociologu i njohur, Fatos Tarifa, na jep një konkluzion shumë të saktë në lidhje me këtë. Ja si shprehet ai “simboli i fundit i shoqërisë civile në Shqipëri u shkatërrua me ndalimin e plotë të fesë, më 1967 dhe me shpalljen antikushtetuese të saj, më 1976” (Tarifa, 2009:103). Sjellim këtu edhe njëherë në vëmendje që për Inglehart-it dhe Baker-in, vlerat fetare përbëjnë bërthamën themelore të boshtit vleror që konsiderohet tradicional. Krasniqi kur bën tabelën, në të cilën klasifikon partitë politike sipas bazës sociale dhe ideologjisë mbështetëse elektorale, vë në dukje që Bosnja, Bullgaria, Kroacia, Kosova, Mali i Zi, Maqedoni dhe Serbia kanë si faktor të bazës sociale edhe fenë, ndërsa te Shqipëria nuk gjendet ky si faktor i organizimit partiak (Krasniqi, 2012:115).

Lamentovic në studimit e tij për komunizmin në vendet e Europës Juglindore, në përmbledhjen e Verner Vajdenfeld: Demokracia dhe ekonomia e tregut në Europën Lindore ku përfshihet edhe Shqipëria, shprehet se “Një temë e preferuar e literaturës komuniste ishte ëndrra utopike për një unitet shoqëror të drejtpërdrejtë... Nuk duhej të kishte asnjë fushë jetësore të ndarë, meqenëse të gjitha interesat vetjake do të shndërroheshin në të përgjithshme dhe vlerat individuale në të mira të përgjithshme; nuk duhej të kishte asnjë ndryshim në kushtet e jetesës dhe për pasojë asnjë përplasje interesash. Toleranca në një shoqëri të tillë, të emancipuar, do të ishte virtyt i panevojshëm” (Lamentovic, 1999:64). Nga sa mund të kuptojmë pikërisht ky ishte edhe qëllimi i komunizmit në Shqipëri duke mos lejuar që individi të mund të besonte te disa vlera të tijat, të familjes, të asaj që gjykonte, por duke iu imponuar nga lart vlerat e përgjithshme tek të cilat ata duhet të besonin. Pikërisht kjo bën që ato të quheshin “antivlera” pavarësisht se çfarë predikonin apo çfarë kishin në përmbajtje, sepse vlerat janë të brendësuar, janë kritere gjykimi personale mbi të mirën dhe të keqen, patjetër siç e pamë edhe në studimin teorik të ndikuar nga shoqëria, nga familja etj. Por që individi duhet t’i ketë si guida të vetat personale dhe jo të imponuara dhe të detyruara me frikë nga pushteti, që i kthen ato në “antivlera”.

Është me vend gjykimi që bën studiuesi, antropologu Dhima, kur shprehet që “Censura ishte në shkallë të lartë dhe shpesh herë liberalizmi dënohej me masa ekstreme. Për fatkeqësinë tonë, diktatura komuniste na çoi në falsifikimin dhe rrënimin e shumë vlerave origjinale, duke i fshirë ato nga “memoria” e historisë, kulturës së qytetërimit tonë”. (Dhima, 2010:198)

E gjitha kjo do të ndikonte në mënyrë të dukshme në atë që do të ndodhte më pas me Shqipërinë, me përkrahjen e saj për vlerat e demokracisë, por edhe me profilin e saj vleror si një tërësi. Nuk duhet të harrojmë që “Shqipëria ishte dhe mbeti i vetmi vend i Europës Lindore që evitoi çdo lloj mendimi revizionist dhe u qëndroi presioneve për hapjen dhe liberalizimin e shoqërisë, përfshirë edhe ato të tipit gllasnost apo perestrojka në gjysmën e dytë të viteve 1980, të cilat ndikuan në zhvillimin e vendeve të tjera ish-komuniste” (Tarifa, 2009:103).

Vendosja e sistemit demokratik në vend do të na bënte që të përballeshim me atë që Lamentovic e rendit si një nga paradokset e vendeve që kanë trashëgimi komuniste, paradoksi i nihilizmit të dyfishtë: “Nihilizmi kundër vlerave të hedhura poshtë, i cili duhet të përgatisë rrugën për modernizim, kthehet në nihilizëm kundër normave, parimeve dhe vlerave të dëshiruara” (Lamentovic, 1999:65). Ashtu siç e ka thënë në studimet e para për vlerat me ardhjen e demokracisë studiuesi Kocani ku “konflikti normativ konsiston në ndeshjen midis modeleve vlerore të “instaluar” në korpusin e “ndërgjegjes kolektive” nga regjimi totalitar komunist dhe modeleve të reja vlerore që ai “huazon” nga shoqëritë demokratike (Kocani, 1999:4). Kështu për shembull studiuesi, Rocca, shkruan pikërisht për këtë gjendje: “Nga njëra anë kritikohet regjimi i vjetër, nga ana tjetër njerëzit kanë mall për barazimtarizmin e tij. Nga njëra anë dëshirohet tregu i lirë, nga ana tjetër dënohet luhajtja e çmimeve. Krahas dëshirës për kufij më të hapur ekziston gatishmëria për të hapur luftë, në rast se rrezikohet sadopak sovraniteti. Dëshirohen sa më s’ka investimet e huaja, por pastaj dënohet shfrytëzimi i pasurive të vendit nga ana e të huajve. Ngrihet lart demokracia pluraliste, por kur një parti vjen në pushtet sillen me të si në kohën e partisë së dikurshme, të vetme, komuniste, duke e konsideruar si të vetmen mënyrë, për të siguruar një punë dhe një pozitë shoqërore” (Rocca, 2000:64).

Studiuesi Dervishi flet për mundësinë se ka shumë të ngjarë që vlerat tona në demokraci të jenë thelbësisht materialiste, ai shprehet: “Në kuadër të kalimin nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e tregut ... u shoqërua me dëshirën për t’u pasuruar shpejt. Kjo nxitë edhe mjaft shqiptarë të zhvendosen në spektrin e vlerave nga ato me përmbajtje më të spikatur humanizuese e deri altruiste, te vlerat me natyrë më të theksuar ekonomike dhe pragmatike, të largohen nga idealizmat dhe të afrohen me botën e interesave materialist, herë-herë vulgare.” (Dervishi, 2005:88). Vetë demokracia ka probleme e saj në funksionimin si e plotë dhe në funksionim me sjellje dhe vlera demokratike të vetë qytetarëve shqiptarë, pjesëmarrja në politikë dhe angazhimi në “punët” e përgjithshme që mund të jenë të nevojshme për të ndërhyrë në publikun e një shteti janë shumë larg realitetit të këtyre viteve të demokracisë në vendin tonë. Arsye e rëndësishme për këtë fakt, sipas Biberajt, është se “për afro gjysmë shekulli Shqipëria kishte qenë e izoluar nga bota e jashtme dhe nga vlerat dhe parimet demokratike. Ky izolim, bashkë me mungesën e traditave demokratike, kishte ngulitur dhe rrënjësuar vlera dhe qëndrime që nuk ishin shumë të favorshme për zhvillimin e demokracisë” (Biberaj, 2011:117).

Regjimi komunist kishte rrënjësuar te qytetari shqiptar, ndjenjën e frikës, sepse në çdo moment ti ishte i dëgjuar dhe i parë nga sistemi (sytë dhe veshët e të cilit mund të ishin kushdo, edhe njeri më i afërt), i cili të ndëshkonte në mënyrë shumë të rreptë në rast se ti mund të mendoje dhe jo më të veproje kundër asaj që kishte vendosur sistemi për ty. Kjo bëri që ndjenja e frikës të ndalonte çdo lloj vlere që mund të kishte qytetari, që përkthej në sjellje normale demokratike, sepse frika nuk ishte vetëm ndaj shtetit, por ishte edhe si mungesë besimi ndaj tjetrit, ndaj qytetarit. Kjo e bën gati të pamundur që, në fillimet e demokracisë, por edhe në vitet më pas, nuk është se ka ndryshuar shumë, qytetarët të bashkëpunojnë dhe të mbështeten te njëri-tjetri për të shprehur në çdo lloj forme kërkesat apo ankesat që mund të kenë për vendimin e një autoriteti, qoftë ku edhe shtetëror. Kjo çon në mungesën e krijimit të një force qytetare e cila mund të ushtrojë presion si një identitet i përbashkët kundrejt shtetit.

Këtë mangësi e vë në dukje dhe studiuesja italiane, Del Rey që shprehet se: “kalimi nga një sistem i bazuar në interesat e kolektivitetit, në mungesën e sistemit -në periudhën e tranzicionit në të cilën individit i sheh interesat e veta si parësore, solli një kontrast mes interesit personal dhe pjesëmarrjes në kolektivitet, duke penguar formimin e një identiteti të ri kolektiv” (Del Rey, 2000:114). Elez Biberaj shkruan: “Ndoshta pengesa më e madhe për krijimin e organizatave dhe grupeve qytetare të qëndrueshme ishte mungesa e autonomisë së vërtetë nga shteti ose partitë politike. ...Një hendek i thellë vazhdonte të ndante sferën publike nga ajo private dhe krijimi i një shoqërie qytetare të fortë mbetej një qëllim i largët (Biberaj, 2011:307). Theodore Kaltsounis një studiues që ka qenë drejtues edhe i një projekti për demokratizimin e Shqipërisë, në librin e tij të botuar pas mbarimit të këtij projekti numëron disa nga faktorët kyç që çojnë në problemet dhe dështimet e demokracisë në vendin tonë, nisur edhe nga çka kishin shkruar dhe botuar më parë studiuesit shqiptarë. Ai numëron këta faktorë: “Mungesën e traditës demokratike; autoritarizmit dhe pushtetit të pakufizuar; ndjenjës së njerëzve që vota e tyre është shkelur; mungesës së aftësive në zgjidhjen e konflikteve; mungesës së transparencës në qeveri; mungesës së infrastrukturës; mungesës së një sistemi të qëndrueshëm ekonomik” (Kaltsounis, 2013:111).

“Në këto vite të demokracisë në asnjë rast nuk është përdorur e drejta qytetare e “revokimit” apo e tërheqjes së organizuar të mendimit të tij politik. Nuk është normale, ndërkaq që demokracia jonë nuk ka tentuar deri tani, të bëjë qoftë edhe një eksperiment të vetëm me demokracinë qytetare me të “drejtën e ndërmjetme” politike të qytetarit. Kjo nuk është gjë e mirë. Ajo flet për formalizim të demokracisë, plogështim të qëndrimit politik të qytetarit. Dhe ky rrezik nuk duhet neglizhuar për të ardhmen e demokracisë tonë” (Tushi, 2010:395). Vetëm qytetarët me vlera afirmimi mund të pasqyrojnë kulturë politike dhe të kërkojnë të jenë në qendër të sistemit politik dhe ekonomik të vendit, ashtu siç është e drejta e tyre legjitime për aq kohë sa kanë zgjedhur të jetojnë në një demokraci.

Konkluzione

Kultura politike në Shqipërinë postkomuniste vuan nga disa mangësi që vijnë si rrjedhojë e komunizmit që ka përjetuar ky vend për 50 vite. Dallohen fare qartë që pasojat më të rëndësishme lidhen me:

- Ekzistencën e frikës për të angazhuar dhe për të dalë në pah të proceseve që kërkojnë ndryshime nga ato që qeverisja ka vendosur. Kjo për hir të së kaluarës komuniste ku dimension i frikës ishte ai që i mbante të lidhur shqiptarët nga mendimet e tyre dhe më pas nga veprimet e tyre kundra një sistemi shtypës.
- Dimensioni e një shoqërie që kërkon të mirat materiale dhe një kulturë thelbësisht materialiste si rezultat i drejtpërdrejtë i vuajtjeve ekonomike që kanë pasur në kohën e komunistët. Kjo bën që të jenë më kërkuar të gjërave materiale dhe të kërkojnë më shumë këtë gjë edhe nga politika dhe shteti. Sesa ideale dhe moral janë më të prirur të kërkojnë të mira materiale.
- Mos rëndësia e aspekteve fetare në programet politike por edhe në kulturën politike vjen edhe si rrjedhojë e mos-ushtrimit të aktiviteteve rituale fetare gjatë komunizmit por thjesht me pasjen e një lidhje shpirtërore me zotin dhe jo me institucionet fetare që e mishërojnë atë në tokë. Kjo na ka bërë më tolerant dhe na ka bërë më të hapur ndaj njëri tjetrit.
- Ekzistenca e censurës së dikurshme dhe auto-censurës është rrënjësuar thellë në kulturën politike dhe reflektohet thelbësisht në mungesën e krijimit e një arenë intelektuale të pavarur apo një mendimi të lirë politik të pa atashuar me partitë politike.
- Së fundmi vështirësia që kanë qytetarët që ta vendosin veten në qendër të sistemit politik dhe të kërkojnë të drejtat e tyre. Kjo lidhet me faktin që kultura e tyre politike është ndikuar nga mentaliteti komunist ku në qendër të sistemit politik ishte shteti dhe partia ose me thjesht partia-shtet. Prandaj qytetarët sot e shohin shtetin në qendër të sistemit politik dhe jo vetëm e tyre. Kjo e ndalon edhe hovin e tyre për të kërkuar të drejtat dhe liritë që i takojnë në një demokraci.

Bibliografi

- Almond, G.A (1983) "Comparative political systems" University of New York: New York
- Biberaj, E. (2011) Shqipëria në tranzicion, rruga e vështirë drejt demokracisë 1990-2010. Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, AHS del Re, E.C. (2000) Motivacionet sociale të krizës. tek Kosta Barjaba, Alberto Gasparini "Rruga shqiptare e modernizimit. Ngjarje, klasa politike, njerëz dhe marrëdhënie ndërkombëtare" Tiranë: Instituti i Sociologjisë Ndërkombëtare GORIZIA
- Dervishi, Z. (2005) Vullnetarizmi - ind i domosdoshëm për funksionimin e humanizimit e shoqërisë, Politika dhe Shoqëria, Revistë Shkencore e Institutit të Studimeve Politike dhe Sociale, Vëll.8 Nr.1 (15)
- Dhima, A. (2010) Hyrje në Antropologji. Tiranë: Ideart
- Gjuraj, E. (2013) Kultura kombëtare në kulturën organizative. Tiranë: UET Press
- Inglehart, R. & Baker, W. (2000) Modernization, cultural change and persistence of traditional values. American Sociological Review, Vol 65, No.1 : (19-51)
- Kaltsounis, Th. (2013) Demokratizimi i Shqipërisë, demokracia nga brenda. Tiranë: UET Press
- Kekezi, H. (2008) Pluralizmi politik- Europa lindora dhe përvoja e shqipërisë. Studime Sociale, Vëll. 2 Nr.1
- Kocani, A. (1999) Konflikti në Shqipëri dhe "lufta e perëndive" në Shqipëria në tranzicion dhe vlerat. Tiranë: Fondacioni Soros
- Krasniqi, A. (2012) Europa Juglindore në periudhën postkomuniste, analizë e sistemeve partiake dhe qeverisëse. Tiranë: teza doktrale, e aksesueshme ne [https://www.google.al/search?q=Afrim+Krasniqi+\(+2012\)+Europa+Juglindore+ne+periudhen+pasko+muniste+%2C&oq=Afrim+Krasniqi+\(+2012\)+Europ+parë+për+herë+të+fundit+në+20+mars+2013](https://www.google.al/search?q=Afrim+Krasniqi+(+2012)+Europa+Juglindore+ne+periudhen+pasko+muniste+%2C&oq=Afrim+Krasniqi+(+2012)+Europ+parë+për+herë+të+fundit+në+20+mars+2013)
- Rocca, R. M. (2000) Shqipëria, rrënjët e krizës. Tiranë
- Sinani, Gj (1999) Fenomeni fetar në Shqipëri. në Shqipëria në tranzicion dhe vlerat. Tiranë: Fondacioni Soros
- Tafili, E. (2008) Tranzicioni politik në Europën Qendrore dhe Lindore. Tiranë: SHBLU
- Tarifa, Fatos(2009) "Paradigma e tranzicionit demokratik" Tirane: OMBRA GVG
- Vajdenfeld, Verner (1995) "Demokracia dhe ekonomia e tregut në Evropën Lindore", Shtëpia e librit & Fondacioni
- Soros Wilson, Richard.W(2010) "Compliance Ideologies :Rethinking political culture" Cambridge University Press

TRANSFORMI I PUSHTETIT NË SHOQËRINË MODERNE

KLEMENTIN MILE

ABSTRAKT

Në këtë artikull shqyrtohen disa teza të sociologut të shquar gjerman, Niklas Luhmann, lidhur me transformimin e pushtetit në shoqërinë moderne. Artikulli ndahet në dy pjesë: në pjesën e parë trajtohet koncepti i shoqërisë moderne, në kontrast me alternativat e ofruara nga teoricinë të tjerë të shoqërisë si Marx, Castells, Beck, Debord dhe Lyotard. Pastaj, në pjesën e dytë të artikullit eksplorohehen tre teza luhmanniane për transformimin e pushtetit në kontekstin e transformimit të shoqërisë nga forma e saj tradicionale në atë moderne.

Fjalë kyç: *pushtet, shoqëri moderne, organizatë, sanksion pozitiv, sanksion negativ.*

Shoqëria moderne

Sipas sociologut të shquar gjerman, Niklas Luhmann, shoqëria bashkëkohore është shoqëri *moderne*, pra një shoqëri e karakterizuar nga diferencimi funksional. Ky koncept rivalizon me alternativat e paraqitura për të përshkruar shoqërinë bashkëkohore si shoqëri kapitaliste (Marx dhe gjithë linja marksiste, neomarksizmi dhe postmarksizmi), shoqëri informacioni (Castells 2010), shoqëri risku (Beck 1992), shoqëri spektakli (Debord 2006), apo shoqëri postmoderne (Lyotard 1984). Moderniteti i shoqërisë bashkëkohore përfshin shumë aspekte, ndër të cilat fakti që kjo shoqëri nuk ka më vetëm një qendër, por është policentrike; nuk ka një pozicion kreu për të gjithë shoqërinë, pasi shoqëria moderne nuk është hierarkike por heterarkike; karakterizohet nga autonomia e nënsistemeve të saj, të cilët operojnë në bazë të kodit dhe programeve të tyre specifike dhe jo duke iu bindur ndonjë diskursi gjithëpërfshirës p.sh moral, fetar ose politik; shoqëria moderne është polikonteksturale, në kuptimin që çfarëdo lloj ngjarje në shoqëri mund të vendoset në kontekste të ndryshme për ta kuptuar dhe interpretuar dhe asnjëri prej këtyre konteksteve nuk gëzon prioritet kundrejt të tjerëve; gjithashtu shoqëria moderne nuk shpërndan më njerëz nëpër nënsisteme siç ndodhte në skemën e stratifikimit ose te diferencimi qendër/periferi, asaj i duhet të bëjë pa një korelat demografik. Ideja është se njerëzit nuk mund t'i atribuohen sistemeve funksionale të shoqërisë moderne në atë mënyrë që një njeri t'i përkasë vetëm një sistemi – p.sh sistemit ligjor, ose sistemit politik, ose sistemit ekonomik etj. Në kushtet e shoqërisë moderne çdo njeri mund të marrë pjesë në shumë sisteme përgjatë jetës së vet. Ky tipar i shoqërisë moderne implikon forma të ndryshme të përfshirjes dhe përjashtimit nga shoqëria: kështu, në parim sistemet funksionale të shoqërisë i përfshijnë të gjithë njerëzit, pavarësisht racës, gjinisë, moshës, besimit fetar etj. (faktorë që ishin kritere përjashtimi në shoqëritë paramoderne), por vetëm nëse plotësojnë kriteret specifike të tyre (p.sh vetëm nëse kanë para, vetëm nëse kanë certifikatë, vetëm nëse kanë diplomë universitare). Së fundi, shoqëria moderne, ndryshe nga shoqëritë e mëparshme, është shoqëri botërore – të gjitha komunikimet, pavarësisht se ku ndodhin dhe se çfarë forme marrin janë të lidhura me komunikime të tjera që i kapërcejnë të gjithë kufijtë gjeografik. Kjo natyrisht është mundësuar nga zhvillimi i jashtëzakonshëm i nënsistemit shoqëror të medias (Luhmann 1995, 1997, 2004, 2013; Moeller 2006).

Transformimi i pushtetit

Luhmann formulon tri teza kryesore për të karakterizuar raportet e pushtetit në shoqërinë moderne. E para ka të bëjë me *ligjin e transformimit të sanksioneve pozitive në sanksione negative* (Luhmann 1990: 158). Kjo tezë lidhet me burimet e pushtetit. Sipas Luhmann-it, burimi shoqëror parësor i pushtetit është gjithmonë kontrolli mbi dhunën fizike superiore, ku bazohet ndërtimi i shtetit. Pa këtë kontroll shteti do të ishte i pamundur. Madje edhe vetë ligji presupozon kontrollin mbi këto mjete sanksionimi. Prospekti i ruajtjes së avantazhit në përdorimin e dhunës fizike ka cilësi specifike që duken të përshtatshme për të ndërtuar themelin e pushtetit. Kjo sepse (1) dhuna fizike është e përgjithshme – e aplikueshme në kontekste shumë të ndryshme, pavarësisht asaj çka imponohet nëpërmjet kërcënimit të dhunës fizike (2) paraqitet si relativisht e qëndrueshme – e pavarur nga tipi dhe intensiteti i motiveve për t'i rezistuar dhe (3) mund të organizohet mirë – mund të transformohet në vendime të të tjerëve lidhur me aplikimin e dhunës fizike dhe këto vendime mund të kushtëzohen dhe programohen.

Luhmann i shikon këto cilësi të dhunës fizike si themelin e së drejtës dhe të politikës në shoqërinë moderne. Por kur bëhet fjalë për shtetin bashkëkohor të mirëqenies sociale, ai shprehet se ky shtet nuk mund të karakterizohet si duhet duke marrë parasysh vetëm pushtetin e bazuar te dhuna fizike. Në fakt, duke kërkuar themele të tjera për politikën, shteti i mirëqenies sociale hyn në një terren pushteti që mbart aspekte problematike. Kjo karakterizohet nga prirjet për t'i transformuar sanksionet pozitive në negative. Luhmann është i ndërgjegjshëm se është e vështirë të bëhet dallimi ndërmjet këtyre dy llojeve të sanksioneve dhe se kjo është çështje interpretimi, çështje përkufizimi e situatës. Megjithatë, ai ofron një kriter dallues. Nëse dikush qartësisht pret dhe mbështetet te performancat pozitive, tërheqja (mos ofrimi) e tyre rrjedhimisht bëhet sanksion negativ. Për shembull, kur ofrohet asistencë sociale rregullisht ndaj një grupi të synuar i cili siguron jetesën me anë të asistencës, mundësia e tërheqjes së asistencës shfaqet si kërcënim dhe transformohet kështu në sanksion negativ. E njëjta gjë mund të thuhet për punonjësit, të cilët mund të bëhen të ndiejnë kërcënimin e pushimit nga puna, ose për partnerët që kanë një kohë të gjatë që zhvillojnë biznes bashkë etj. Pra, sa më shumë dikush mësohet me avantazhet, aq më shumë rritet pushteti potencial si rezultat i mundësive që sjellin me vete sanksione negative: pushteti potencial i tërheqjes. Në këtë mënyrë rritet pushteti social: si pushteti i ndihmuesve dhe kujdestarëve; si pushteti i pjesëmarrësve; si pushteti i atyre që ofrojnë konsensusin ose praninë e tyre për një çështje; si pushteti i të gjithë atyre që mund t'i ndryshojnë gjërat duke u thënë “Jo!” pritishtë ekzistuese.

Luhmann është i mendimit se ky lloj pushteti është pjesërisht i padëmshëm dhe pjesërisht i përjashtuar, me anë të mbrojtjes që sigurojnë mekanizmat ligjore dhe maksimat politike. Por shanset e transformimit të sanksioneve pozitive në sanksione negative linden vazhdimisht përmes shërbimeve gjithmonë e më të shumta që ofrojnë të tjerët. Kështu këto bëhen burime pushteti me cilësi politikisht të rrezikshme. Ato (1) nuk mund të centralizohen (përveçse po të centralizohet e gjithë asistencja) dhe qëndrojnë të përhapura; (2) përdorimi i tyre nuk mund të kontrollohet; (3) janë të përshtatshme më shumë për të penguar se sa për të promovuar një sjellje specifike. Pushteti i tërheqjes bëhet problem politik si pushteti për të bllokuar (Luhmann 1990: 158-160).

Teza e dytë e Luhmann-it është se *pushteti në shoqërinë moderne nuk ushtrohet më në bazë të shtresës sociale, por në bazë të organizimit formal* (Luhmann 1990: 158). Raportet e pushtetit në sistemin shoqëror bashkëkohor nuk mund të kuptohen po

të nisesh nga koncepti i një shtrese, klase apo elite sunduese. Sigurisht, ka persona që zënë pozicionet e lidërshiptit dhe që i kanë më të lehta kontaktet brenda këtyre grupeve. Por anëtarësia në këto grupe lidërshipti nuk manifestohet si familje ose grup miqësor, por lind nga perceptimi i pozicioneve organizative. Ndryshe nga shoqëritë e mëparshme, nuk mund të supozohet që një shtresë e shoqërisë krijon solidaritet ndërmjet anëtarëve të saj. Dhe probabiliteti është i ulët që mënyra sjellje tipike për një shtresë të caktuar të mund të drejtojnë me sukses procesin e ushtrimit të pushtetit. Kjo do t'i korrespondonte një tipi shoqërie në të cilën pushteti politik qëndron akoma esencialisht te kontrolli i aksesit për dhunë fizike superiore. Sipas Luhmann-it, ky nuk është më rasti. Sot rritja, diversifikimi material dhe përpunimi i pushtetit varen nga organizimi formal. Kjo duket te zhvillimi i zinxhirëve më të gjatë dhe më të qëndrueshëm të pushtetit, te format indirekte të përdorimit të tij për të drejtuar ushtrimin e pushtetit nga të tjerët, dhe te efektiviteti i rritur, pasi me një vendim dikush mund të shkaktojë marrjen e shumë vendimeve të tjera që rezultojnë prej tij.

Organizata është një mekanizëm që e diferencon dhe e shpërndan pushtetin, por jo si një mall të dhënë. Shpërndarja, nga ana e saj, krijon dhe ndryshon atë çka shpërndahet. Luhmann shprehet se teoria borgjeze e shoqërisë kërkonte ta fuste mekanizmin e diferencimit në teorinë e ndarjes së pushteteve dhe në teorinë e konkurrencës ekonomike, me qëllim që ta kufizonte pushtetin dhe ta reduktonte në atë çka ishte ligjërish dhe lejueshme ose ekonomikisht racionale. Por në zbatimin e këtij programi zbulohet pashmangshmërisht se formimi i organizatave gjithashtu e shumëfishon pushtetin - edhe pse jo në forma të kontrollueshme prej qendrës. Në këtë mënyrë situata e problemit zhvendoset gradualisht. Sipas Luhmann-it sot çështja nuk është më aq shumë keqpërdorimi i pushtetit, sesa tepria e pushtetit të papërdorshëm që shoqëria prodhon përmes organizatave (Luhmann 1990: 161-2).

Edhe pushteti organizativ nuk është gjë tjetër veçse një rast i aplikimit të transformimit të sanksioneve pozitive në negative. Ai mbështetet te fakti që anëtarësia në organizata mund të jepet si *avantazh*, ndërsa mosdhënia e anëtarësisë ose tërheqja e saj mund të përcaktohet si *sanksion negativ*. Kjo gjë është tipike në realitetin organizativ të marrjes në punë dhe pushimit nga puna. Por megjithatë pushteti në organizata nuk mund të mbështetet vetëm te kjo mënyrë, pasi ajo është shumë e papërpunuar dhe në fakt përdoret vetëm për të marrë vendime në raste konfliktesh serioze. Kështu transformimi i avantazheve të anëtarësisë në sanksionin negativ që rrjedh prej mosdhënies ose heqjes së saj përdoret vetëm në situata ekstreme dhe gjeneron pushtet vetëm për sa kohë sanksioni *nuk ushtrohet*. Sipas Luhmann-it, nuk lejohet të lindin konflikte që mund të kërcënojnë anëtarësinë, përveçse nëse dikush tashmë ka vendosur të largohet nga organizata dhe prandaj krijon një konflikt heroik të fundit për ta përdorur si pretext për largimin (Luhmann 1990: 162). Për më tepër, pushteti përpunohet përmes kontrollit të vendimeve për personelin, që lidhet me karrierën e anëtarëve brenda organizatës. Kështu, çështja se sa lart qëndron një anëtar në shkallën organizative bëhet instrument pushteti. Madje edhe mos promovimi, ose riorganizimi i shoqëruar me rishpërndarje të disa avantazheve, bëhet instrument pushteti ndaj të cilit anëtarët përshtaten duke hamendësuar vendimin e eprorit.

Por si çdo tip tjetër pushteti, edhe pushteti organizativ ka limitet e veta. Ato lidhen kryesisht me faktin që çdo rritje pushteti sjell një mbingarkesë të qendrave të kontrollit. Këto të fundit varen nga paraseleksionimi i vendimeve të tyre prej vartësve dhe, në lidhje me këtë, nga empatia e tyre dhe vullneti për të bashkëpunuar. Kjo herë pas here u jep vartësve pushtetin për të demonstruar që bashkëpunimi nuk mund të merret si i mirëqenë (Luhmann 1990: 162-3).

Luhmann tërheq vëmendjen te fakti që pushteti jopolitik ushtrohet vazhdimisht në bazë të organizimit formal (Luhmann 1990: 160). Ai dallon dy forma kryesore të pushtetit në organizata: pushteti *organizativ* dhe pushteti ndaj *personelit* (Luhmann 1979: 177-9). Siç u përmend më sipër, pushteti organizativ vepron duke përdorur si sanksion negativ potencialin për t'i përjashtuar njerëzit. Por ky pushtet nuk ka fleksibilitetin e nevojshëm dhe i rrit shumë kostot e organizatës, pasi kjo do të thotë të pushohen nga puna (të humbasin anëtarësinë) njerëz për të cilët organizata mund të ketë shpenzuar shumë kohë dhe burime financiare për t'i trajnuar dhe që zakonisht nuk është e lehtë të zëvendësohen menjëherë. Për këtë arsye në organizata përdoret më së shumti forma tjetër e pushtetit: pushteti ndaj personelit. Ky pushtet lidhet me mundësitë për promovim dhe democion, pra me mundësitë për të zhvendosur në pozicione të larta ose të ulëta në hierarkinë e organizatës. Me fjalë të tjera, kjo formë pushteti e kushtëzon veprimin e anëtarëve përmes sanksioneve ndaj karrierës.

Teza e tretë e Luhmann-it lidhet me *lindjen e diferencave të theksuara ndërmjet pushtetit real dhe pushtetit të atribuuar, shoqëruar nga prirje inflacioniste ose deflacioniste të pushtetit* (Luhmann 1990: 158). Për shkak të ekzistencës së sistemeve organizative komplekse në shoqëri, pushteti organizativ vlerësohet ndryshe nga jashtë organizatës dhe ndryshe nga brenda saj. Kur shihet nga jashtë, ka një mbivlerësim tipik të homogjenitetit të organizatës dhe aftësisë së saj për të zbatuar pushtetin organizativ. Pushteti i atribuohet krerëve të organizatës, por në realitet ekzistojnë balanca pushteti të komplikuar që variojnë sipas temave dhe situatave. Pra kreut të organizatës i atribuohet më shumë pushtet sesa ka realisht. Ky proces atribrimi shkakësor sjell pasojë në raportet reale të pushtetit. Kështu së jashtmi organizatës i duhet të respektojë atribimin e pushtetit, përndryshe personat jashtë organizatës nuk do mund ta shihnin dhe trajtonin organizatën si rend. Për personat e jashtëm që merren me organizatën janë të nevojshme thjeshtëzimet që mundësojnë raportet brenda-jashtë. Për këtë arsye duhet promovuar dhe mbështetur edhe prestigji i pushtetit të krerëve të organizatës. Në këtë mënyrë atribimi i jashtëm i pushtetit bëhet faktor pushteti në konfliktet e brendshme. Krerët mund të kërcënojnë largimin nga organizata ose mund të krijojnë situata që ekspozojnë për vëzhguesit e jashtëm se organizata nuk funksionon si unitet vendimmarrës dhe zbatues. Kjo formon bazën e një lloji pushteti informal të krerëve formal, i cili mbështetet te fakti që pushteti u atribuohet atyre dhe ky atribim, si proces përgjithësimi simbolik, është i ndjeshëm ndaj informacionit për faktet. Sipas Luhmann-it kjo aplikohet në shkallë të ndryshme nëpër organizata të llojeve të ndryshme. Kështu për partitë politike më shumë se për universitetet, për organizatat masmediatike më shumë se për shërbimin postar, për ushtrinë më shumë se për bankat (Luhmann 1990: 163-4).

Duke transferuar konceptet *inflacion* dhe *deflacion* nga teoria e parasë te teoria e pushtetit (duke qenë se të dyja janë media komunikimi të përgjithësueshme simbolikisht), Luhmann shprehet se ashtu si në ekonominë monetare, edhe në domenin

e pushtetit duket të ketë vetëm një *overdraft të kufizuar burimesh të vlefshme*, të cilat mund të përngjasohen me kreditin. Pushtetmbajtësi merr më shumë vendime dhe siguron bindje për më shumë vendime sesa mund të bëjë efektive në raste konflikti. Nëse pushtetmbajtësi e përdor *shumë pak* pushtetin që i atribuohet dhe e kufizon veten brenda pushtetit që “ka me të vërtetë”, kështu ai shkakton një prirje *deflacioniste*. Ai operon shumë pranë mjeteve të tij të sanksionimit. Dhe rreziku me këtë është se ai nuk arrin të largohet nga zona e kërcënimit të ushtrimit të pushtetit drejt zonës së ushtrimit të suksesshëm të pushtetit. Nga ana tjetër, nëse pushtetmbajtësi mbështetet *shumë fort* te pushteti që thjesht i atribuohet, ai shkakton një prirje *inflacioniste*. Në këtë rast ai bëhet i varur nga sukseset e dukshme që demonstrojnë se ka pushtet. Njëkohësisht ai bëhet vulnerabël nga krizat, të cilat tregojnë se ai nuk mund t’i mbulojë vendimet me sanksione (Luhmann 1990: 164-5).

Bibliografi

- Beck, Ulrich. 1992. *Risk Society: Towards a New Modernity*. Sage Publications.
- Castells, Manuel. 2010. *The Rise of the Network Society*. Wiley-Blackwell.
- Debord, Guy. 2006. *Society of the Spectacle*. Rebel Press.
- Luhmann, Niklas. 1979. *Trust and Power*. Wiley.
- Luhmann, Niklas. 1990. *Political Theory in the Welfare State*. Walter de Gruyter.
- Luhmann, Niklas. 1995. *Social Systems*. Stanford University Press.
- Luhmann, Niklas. 1997. *Observaciones de la modernidad*. Paidós.
- Luhmann, Niklas. 2004. *Law as a Social System*. Oxford University Press.
- Luhmann, Niklas. 2013. *Theory of Society, Vol. 2*. Stanford University Press.
- Lyotard, François. 1984. *The Postmodern Condition: A Report on Knowledge*. University of Minnesota Press.
- Marx, Karl & Friedrich Engels. 1970. *Manifesto of the Communist Party*. People’s Publishing House.
- Moeller, Hans-Georg. 2006. *Luhmann Explained. From Souls to Systems*. Open Court.

ROLI I ORIENTALIZMIT NË MODERNITETIN SHQIPTAR

DOK. LULZIM HOXHA

Hyrje

Duke bërë pjesë për pothuajse 500 vjet në Perandorinë Osmane dhe qysh prej të paktën 300 vjet me një popullsi mbizotëruese myslimane nuk mund të ndodhte që Shqipëria, më shumë akoma se të gjitha vendet ballkanike, mos t'i nënshtrohej ndikimit kulturor turko-oriental që u shtri jo vetëm tek gjuha dhe kultura material, por edhe duke mbrytur krijimtarinë letrare të shqiptarëve dhe bëri që të lindë një letërsi e rregullt shqipe (Bartl Peter: 2006, f.160). Për të dëshmuar ndikimin e gjuhës turke tek shqiptarët, historian Peter Bartl duke cituar gjuhëtarin Gustav Meyer shkruan se “nga 5140 fjalë kryesore, rreth 1180 ishin me prejardhje turke” (Ibid). Ky aspekt nuk vihet re vetëm tek pjesa myslimane e shqiptarëve, por edhe tek pjesa katolike ndonëse në një nivel më të kufizuar, vihet re një ndikim i rëndësishëm i orientalizmeve gjuhësore. Kështu për shembull Lok Limthi duke hulumtuar mbi veprën më të njohur të Gjergj Fishtës “Lahuta e Malcis” rezultoi se në këtë libër janë përdorur 364 turqizma (Limthi: 1961, Shtejzat 5, 86-92). Për të treguar ndikimin e osmanishtes edhe në Shqipërinë pas pavarësisë, Eqrem Bej Vlora pohon se “Të gjitha veprimet nëpër zyrat e kadastrës deri në vitin 1920 janë kryer po në gjuhën osmane” (Vlora E, Dosja A-VII-5, 55). Një tregues që dëshmon se osmanishtja ka mbetur një gjuhë komunikimi mes intelektualëve shqiptarë deri në fillim të viteve 40’ janë disa letra të shkruara osmanisht që intelektualë shqiptar i kanë dërguar Eqrem Bej Vlorës (Egro: 2007, 58). Revistat katolike të urdhrorit Françeskan “Hylli i Dritës” dhe “Leka” kishin prirje të vinin theksin vetëm tek aspektet negative të shtetit osman duke evidentuar përplasjen që Krishtërimi katolik dhe Islami patën në tokat shqiptare (Po aty, 71).

Roli i myslimaneve në ndërtimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare

Përplasia mes katolikëve dhe myslimanëve në periudhën pas pavarësisë u paraqit si përplasje midis atyre që kërkonin të shkonin drejt “Europës” dhe atyre që preferonin të qëndronin në orientin statik e të prapambetur. Një prej intelektualëve më të njohur të nacionalizmit shqiptar gjatë periudhës midis dy luftërave ishte Branko Merxhani. Në lidhje me dallimin e Perëndimit nga Lindja, ai shpjegonte se “Zhvillimi i perëndimit dhe dallimi i tij nga lindja filloi me urbanizimin në Europë, sepse rritja e dendësisë së popullatës së qyteteve çoi në rritjen e specializimit të ndarjes së punës. Me kohë, Perëndimi e kapërceu mesjetën dhe hyri në epokën modern, kurse Lindja mbeti në këtë etapë historike deri vonë” (Merxhani B: 2003, 149-151). Më pas ai shton se “Jemi të shtrënguar me dashje e pa dashje të ecim për në oksident” (Po aty, 237). Ashtu sikurse kronikanët perëndimorë dhe autorët e krishterë u referoheshin Osmanëve si “turq” meqenëse identiteti etnik – sikurse është thënë më sipër – në Europë kishte prioritet, edhe tek katolikët shqiptarë pas pavarësisë përdorej fjala “turk” për të nënkuptuar prapambetjen dhe pushtimin e dhunshëm Osman. Perceptimi i Perandorisë Osmane si “turq” synonte shmangien e lidhjeve me formacionin multietnik, pjesë e të cilëve ishin edhe vetë katolikët shqiptarë. Shpeshherë historiografia shqiptare e pas pavarësisë priret ta shohë periudhën e Perandorisë Osmane duke u nisur nga konteksti i sotëm dhe duke mos i kushtuar rëndësi faktit se kemi të bëjmë me një Perandori e cila për nga organizimi shoqëror, identiteti lokal, pushteti qendror dhe modeli ekonomik nuk kanë fare lidhje me shtetet-kombe si Turqia apo Shqipëria. Po ta shohim ngjarjen për kontekstin e periudhës historike në fjalë do vërehej se “Ngaqë nocioni ‘kombësi’ nuk ekzistonte në konceptin shtetëror Osman, u arrit që shteti Osman të qëndronte mbi komunitetet e ndara të princave feudale” (Egro: 2007, 136). Mungesa e homogjenitetit kulturor, politik dhe gjuhësor në Shqipëri deri në fillimet e shekullit të njëzetë lidhet me mungesën e modernitetit në periudhën e Perandorisë Osmane duke i qëndruar strikte linjës së “Mënyrës Aziatike të Prodhimit” e cila me sa duket ishte një koncept që mbështetej në periudhën e Komunizmit sikurse na tregon libri i Petrika Thëngjillit “Renta feudale dhe evoluimi i saj në viset shqiptare në shekujt XVII-XVIII”. Madje historian Sami Pulaha shkon edhe më tej kur shkruan se “Një faktor i parë politik, që ndikoi në përhapjen e fesë Islame ishte kolonizimi, duke vendosur familje të tëra në zona të ndryshme të Shqipërisë” (Pulaha S: 1978, f.50). Me sa duket, ashtu sikurse tradita historike përpara vitit 1945, shkëputja nga e kaluara Osmane do të vendosej në qendër të studimeve komuniste, por ndryshe nga studimet e para Luftës së parë Botërore që kishin si synim ta afronin shtetin shqiptar drejt perëndimit, në rastin e sistemit komunist synohej që e shkuara Osmane të paraqitej si faktor stanjacioni i vendit. Një pjesë të mirë të stereotipeve mbi orientin, të krijuara në periudhën romantiko-nacionale dhe atë komuniste i kritikon Isa Blumi në librin e tij “Reinstating the Ottomans” i cili na jep një perspektivë krejt të ndryshme në lidhje me periudhën e sundimit Osman në Shqipëri, veçanërisht në shekujt XIX-XX. Ai argumenton se (Blumi: 2011, f.9) ndryshe nga sa mendohet në historiografinë shqiptare pas pavarësisë, “Ismail Bej Vlora nuk do të ulej i vetëm në Ballkonin e një historie moderne të shqiptarëve. Ai do ta ndante unitetin e së shkuarës së Ballkanit perëndimor me shumë të tjerë, me të cilët bashkë ndanin të shkuarën e tyre Otomane.” Autori flet për një histori alternative të modernitetit shqiptar, çka pasqyron vështirësitë që paraqiten në përkufizimin e modernitetit si dhe shumësitë e llojeve të ndryshme të tij. Historiografia e pas pavarësisë na ka prezantuar me figurën e Ismail Qemalit si një ndër figurat qendrore të “kombit shqiptar”, ndërkohë që Ismail Qemali si politikan është evidentuar në administratën Otomane, ashtu sikurse pjesa dërrmuese e figurave të politikës shqiptare në fillimin e shekullit të njëzetë. Përkundër analizës klasike që i bëhet periudhës së Perandorisë osmane, në të cilën simplifikohet ndjeshëm mënyra e organizimit dhe thyerjet e shumta që kanë ndodhur në më shumë se katër shekuj histori, në fakt Perandoria Osmane ka qenë një shoqëri tepër komplekse, të karakterizuar nga ndryshime të vazhdueshme politikash shtetërore dhe njësisish territoriale. Tek “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet?” Sami Frashëri duke qëndruar në të njëjtën linjë shkruan se “Nën sundimin turk shqiptarët morën një pozitë të parapëlqyer, shumë prej tyre patën poste të larta në ushtri dhe në administratën perandorake.” Ndryshe nga tezat e periudhës romantiko-nacionaliste ku prirjet orientaliste kundrejt shtetit

Otoman janë të qarta, Samiu thekson se gjatë shekujve, arnautët dhe osmanët shkronin mirë me njëri-tjetrin. Sepse ato që donin arnautët: pasurinë, respektin, armët, kuajt, prenë si dhe lirinë e tyre të domosdoshme, ato i gjenin tek turqit; dhe ato që kërkonin turqit; trimërinë, besnikërinë, përbuzjen e vdekjes i gjenin tek shqiptarët” (Frashëri: 1962, f.12). Po kështu, Eqrem Bej Vlora thekson se “Asnjë shqiptar, me përjashtim të disa kokave të ndezura, që nuk njohin, janë pa përvojë për gjendjen e vërtetë në vend, nuk ëndërron për një Shqipëri të pavarur. (Eqrem Bej Vlora tek “Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare, 2006). Ndryshe nga versioni nacional-romantik ku thuhet se revoltat e viteve 1905-1907 të shqiptarëve të Perandorisë ishin revolta për pavarësi kombëtare, Pater Bartl shkruan se “Kryengritjet e viteve 1905-1907 ishin revolta lokale me synime lokale – ruajtja e privilegjeve, protesta kundër futjes së taksave e detyrimeve të tjera dhe kundër arbitraritetit të nëpunësve turq” (Po aty, f.86). Në kryengritjet e vitit 1908 duke iu referuar një fotografie të kohës ku paraqiten disa kryengritës të veshur në mënyrë të ndryshme nga njeri-tjetri, me kostume kombëtare të vendeve të ndryshme, del në konkluzionin se “këta njerëz nuk po festonin rënien e sulltanit me synim për të ngritur kauzën e kombit shqiptar. Në të vërtetë, në verë të vitit 1908 ishte themelimi i një regjimi të ri Otoman dhe ishte pikërisht kjo ngjarje që i bëri këta njerëz të mblidhen së bashku. Me fjalë të tjera: reformimi i Perandorisë për këta burra ishte diçka thelbësore” (Blumi: 2011, f.13). Po të bazohemi në argumentin nacional-romantik, do të mund të thonim se revoltat lokale në periudhën e Perandorisë Osmane kishin aspirata kombëtare dhe ishin këto revolta që sollën lindjen e kombit shqiptar. Nëse e shohim nga konteksti i sotëm modern, ky lloj argument mund të bëjë kuptim, por nëse kthehemi në retrospektivë në kontekstin e vendit ku kanë ndodhur këto ngjarje, kryengritjet e Mirditës dhe ato të jugut të Shqipërisë vështirë se mund të themi se kishin mburjtur të njëjtën ndërgjegje kombëtare brenda një komuniteti aq heterogjen. Nëse do të prireshim që ta shohim periudhën e Perandorisë osmane në optikën e periudhës pas pavarësisë do dilnim në përfundimin se meqenëse një pjesë e mirë e administratës Otomane përbëhej nga shqiptarë Toskë, ndërsa kryengritjet e vitit 1908 kryesisht ishin ngjarje që ndodhën në pjesën Gegë, atëherë shqiptarët po luftonin me njëri-tjetrin. Por nëse do i referoheshim kontekstit të kohës, duke qenë se kemi të bëjmë me një Perandori të organizuar me një strukturë krejt të ndryshme nga shtet-kombi modern, automatikisht etiketimi i tyre në terma kombëtar nuk do na ndihmonte të shpjegojmë asgjë. Për sa i përket periudhës së shekujve XVIII-XIX e cila konsiderohet si epoka ku i ka fillimet moderniteti dhe forcimi i ndikimit shtetëror në gjithë territorin e vendit, diçka e ngjashme mund të gjejmë edhe në rastin e Perandorisë Osmane në kohën e reformave të Tanzimatit (1839-1876). Gjatë kësaj kohe, Shteti Otoman synonte zgjerimin e autoritetit shtetëror në gjithë territorin e vendit, midis të tjerash edhe në zonën e Gegnisë. Si rrjedhojë e kësaj, do të ishin burokratët Toskë që promovuan rritjen e autoritetit shtetëror në zonat Gegë, çka do të sillte implementimin e disa politikave të cilat në kontekstin e sotëm do të konsideroheshin si raciste (Blumi: 2011, f.37). Shumica e elitës Toskë që qeveriste Perandorinë mendonin se komunitetet malësore të veriut nuk ishin veçse njerëz të egër që duhet të civilizoheshin (Blumi, po aty, f.17). Në kohën e Tanzimatit, komunitetet lokale të veriut të qeverisura deri asokohe nga Bajraktarët, do të sakrifikoreshin për një shtet më të centralizuar. Prezumimet e periudhës modern sipas të cilës turqit ishin uzurpues të një shoqërie të krishterë para-ekzistuese dhe i shtypi retorikat nacionaliste të këtij komuniteti, nuk janë veçse argument esencialiste të një komuniteti kombëtar primordial. Kombi primordial nuk është veçse sajësë e nacional-romantizmit të fillimit të shekullit të njëzetë, dhe më pas u amplifikua më tej nga regjimi Nacional-komunist i Enver Hoxhës. Ky argument duket se përjashton ekzistencën e momenteve alternative të modernitetit gjatë periudhës kur shqiptarët ishin pjesë e shtetit Otoman. Në këtë drejtim, një ndër figurat më interesante të kombëtarizuara dhe të orientizuara ishte padyshim figura e Ali Pashës, guvernatorit të Sanxhakut të Janinës, i cili njihet rëndom si një ndër personalitetet që luftoi Sulltanin për hir të pavarësisë së shqiptarëve. Në vitin 1787 qeveria Otomane e emëroi Ali Pashën guvernator të sanxhakut të Janinës. Gjatë kësaj kohe ai shtypi kryengritje të shumta lokale si ajo e Mahmut Pashë Bushtatit në Shkodër apo kryengritje të tjera të “banditëve” lokal. Gjatë kësaj periudhe shteti Otoman qeverisej nga një bashkëpunim midis qeverisjes qendrore dhe ajanëve lokalë të cilët ishin përgjegjës për rajone të caktuara. Isa Blumi shkruan se gjatë luftës së Perandorisë me fuqitë e mëdha, Ali Pasha ishte një ndër personat më të pushtetshëm që luftonin në krah të sulltanit. Megjithatë, gjatë kohës së rritjes së influencës britanike, ruse dhe franceze ai u përpoq ta fuqizonte pushtetin e tij duke përkrahur herë Perandorinë herë fuqitë e mëdha. Ajo çka është karakteristike e kësaj periudhe është se Ali Pasha synonte të krijonte një shtet të madh brenda shtetit Otoman dhe ai nuk militonte për separatizëm politik, por në të vërtetë synonte të zinte një pozicion sa më komod në administratën Otomane ende të paprekur nga reformat centralizuese të Tanzimatit (Blumi: 2011, f.69). Nëse i shohim nga perspektiva e sotme do të thonim se ai kishte një identitet të fortë kombëtar (Shqiptar i jugut/ Tosk) apo fetar (Bektashi). Mirëpo pyetja që vlen të ngrihet është: a ishte veprimtaria e Ali Pashës e motivuar nga nacionalizmi Tosk apo ai Bektashi? Nga ana tjetër, parë nga perspektiva e sotme do të ishte i pakuptimtë kontributi i Toskëve të Shqipërisë në luftën për pavarësi të shtetit grek (Xoxi: 1991, 134). Në këtë kuptim, separatizmi grek lëvroi tek shqiptarët një përzierje të ligjërimeve nacionaliste dhe orientaliste të fokusuar kryesisht tek anti-islamizmi dhe përqaftimi i besimit fetar të Krishterë.

Një modernitet provizor

Në kohën e reformave të Tanzimatit, periudhë të cilën Isa Blumi e konsideron si një “Modernitet provizor” (Blumi, 2011, 72), ndër tiparet më të rëndësishme për t’u evidentuar ishte transferimi i pushtetit nga Sulltani tek burokracia e Perandorisë, të njohur si Porta e Lartë. Kjo mundësoi një ndryshim të rëndësishëm në hierarkinë e perandorisë, ku pjesa kryesore e pushtetit do të ishte në duart e elitës së re burokratike, tipar i cili sipas Hobsbaëm përbën një ndër elementet më të rëndësishme të shtetit modern (Hobsbaëm: 2012, f.48). Po kështu, gjatë kësaj periudhe mund të identifikojmë edhe të tjera elemente të

modernitetit si: forcimin e autoritetit qendror dhe kontrollin e shtetit në gjithë territorin si dhe rënien e pushtetit të atyre që në botën perëndimore do quheshin “feudalët lokal”, ekuivalentët e të cilëve në perandorinë Osmane ishin ajanët. Ngritja në këmbë e një rrjeti arsimor modern, si edhe rritja dhe centralizimi i administratës kishin qenë objektivat madhore të autoriteteve osmane që prej kohës së Tanzimatit. Shtirja e rrjetit shkollor dhe e burokracisë, po ashtu edhe zhvillimi i rrjetit të telegrafit, rrjetit rrugor, rrjetit hekurudhor, ekupeve të regjistrimeve ose rrjeti i informatorëve kishin ndihmuar në shtimin e kontaktit midis shtetit dhe shoqërisë (Clayer: 2009, 310). Por ky modernitet provizor nuk qëndronte i izoluar por ai ishte vazhdimisht në ndërveprim me vendet e tjera perëndimore. “Në kohën e Tanzimatit, rrjeti i ri që imitonte sistemin perëndimor, mendohej si një sistem arsimor për të gjithë subjektet e perandorisë” (Georgeon Francois: 1995). Nathalie Clayer shpjegon se periudha e Tanzimatit e cila u karakterizua nga disa elemente të modernitetit Europian në fakt kishte si funksion rezistencën ndaj influencës së perëndimit në shtetin Osman. Me fjalë të tjera, reformat e Tanzimatit pavarësisht se mbartnin aspekte të modernitetit Europian, u implementuan si kundërvënie ndaj këtij të fundit duke manifestuar disa aspekte që nuk mund t’i gjejmë në modernitetin perëndimor. Kështu duket se teoria e moderniteteve të shumëfishta i përgjigjet deri diku zhvillimeve të kësaj periudhe, por ama ajo nuk është në gjendje të na thotë arsyen pse moderniteti ndryshon në bazë të kontekstit ku ai vendoset. Siç ka treguar Benjamin Fortna, rrjeti shkollor dhe masivizimi i arsimit në fakt “ndihmonin për t’iu kundërpërgjigjur ‘kërcënimit’ të misionarëve të Krishterë (siç ishte për shembull ndikimi i misionarëve Françeskanë në veri të Shqipërisë), propagandës së vendeve fqinje si dhe aktiviteteve të ‘minoriteteve’”. Kurset u ndryshuan dhe theksi u vu mbi disiplinën në shoqëri, besnikërinë ndaj Sulltanit, dhe mbi vlerën dhe parimet fetare” (Fortna Benjamin: 2002). Dërgimi i predikuesve, ndërtimi i xhamive dhe fondacioneve shkollore shkonin të gjitha në të njëjtin hap. Këto veprime synonin forcimin e patriotizmit Osman dhe të bindjeve fetare (islamike) (Clayer: 2009, 312). Nga këto të dhëna del se gjatë kësaj kohe Perandoria Osmane po përpiqej të instalonte një lloj homogjenizimi në të gjithë territorin e vendi, gjë që do të kulmonte me lindjen e një kombi Osman ku të gjithë do të flisnin një gjuhë të përbashkët dhe të gjithë qytetarët do të qeveriseshin nga administrata e re Osmane. Carter Finley ka përshkruar mekanizmat dhe rrjedhojat kryesore të këtij plani në rrafshin shoqëror: Kalimi nga shërbimi i skribëve që funksiononte mbi një model esnafor dhe patriarkal në një administratë, e cila teorikisht ishte e organizuar sipas një sistemi racional dhe e mbështetur në ligje të shkruara; rritja e konsiderueshme e kësaj administrate gjatë procesit të centralizimit, për shkak të forcimit të rrjetit administrative në të gjitha shkallët e tij; ndarja e funksioneve; një shumëllojshmëri e profileve dhe e horizonteve kulturore të funksionarëve (Carter Findley tek Clayer: 2009, po aty). Këto strategji politike pasqyrojnë njëkohësisht reduktimin e pushtetit lokal të ajanëve dhe forcimin e centralizimit të një qeverisjeje moderne. Sikurse kam shkruar më sipër, për të kuptuar modernitetin nuk është e mjaftueshme që të hulumtojmë një kontekst politik dhe shoqëror të caktuar duke e interpretuar konceptin e modernitetit si një fenomen që merr formë në një “ishull” të izoluar. Në fakt kur flasim për mënyrën se si moderniteti merr formë në një shoqëri të caktuar, duhet të kemi parasysh edhe ndërveprimin e kësaj shoqërie me vendet e tjera fqinje. Thënë ndryshe: koncepti i modernitetit në këtë punim është interpretuar sipas qasjes së ndërveprimit simbolik, përmes së cilës reformat dhe zhvillimet politike dhe shoqërore të kësaj periudhe duhet t’i shohim si kundërvënie apo si rezistencë kundrejt forcave të jashtme që perceptohen si ‘kërcënues’ të status-quo-së ose formacioneve politike të periudhës para-moderne. Duke iu referuar politikave identitare që shpalosen me rritjen e ndërveprimit të kulturave të ndryshme dhe raporteve të forcave që janë gjithnjë në ndryshim e sipër, do të kemi një pamje më të qartë mbi format e ndryshme që merr moderniteti në kontekste të ndryshme ku ai vendoset. Në këtë drejtim, zhvillimet e Perandorisë më të madhe orientale të kësaj periudhe na bëjnë të kuptojmë se strategjia politike e administratës Osmane gjatë kësaj kohe po perëndimorizohej, por nga ana tjetër mënyra se si këto strategji politike implementoheshin në shoqëri kishte një formë krejt të ndryshme nga perëndimi. Është e vërtetë se konflikti i Ali Pashës me Sulltanin të kujton konfliktet e borgjezisë me aristokracinë Europiane që kulmuan me revolucionet borgjeze të shekullit të tetëmbëdhjetë, megjithatë ndryshe nga borgjezia e trashëguar europiane që me kalimin e kohës u kthye në balancues të pushtetit të mbretit, ajanët si Ali Pasha apo Mehmet Aliu dhe pushteti që ato morën nuk binte në kundërshtim me pushtetin e Sulltanit, përkundrazi ata ishin përgjegjës për ruajtjen e legjitimitetit të tij në lokalitetet ku qeverisnin. Ardha e këtij moderniteti provizor argumentohet sipas Isa Blumit me dy ngjarje kryesore: Së pari për shkak të dështimit në implementimin e politikave shtetërore nga ana e patriarkëve lokal, jo për shkak të rezistencave me sfond nacionalist të këtyre të fundit, por për arsye sepse ata ishin fokusuar më së tepërmi në rritjen e avantazheve dhe të pushtetit të tyre politik në rajonet ku ishin vendosur. Ndërsa faktori i dytë ishin luftërat e Perandorisë me fuqitë e mëdha, sidomos lufta me Rusinë e cila përfundoi me humbjen e Krimesë e cila deri në atë kohë kishte qenë nën administrimin e Perandorisë. Gjatë këtyre luftërave u shfaqën limitet ushtarake të shtetit Osman, gjë që solli në rritjen e influencës perëndimore në territoret e Perandorisë. Ishte pikërisht rritja e influencës perëndimore që u shoqërua me kultivimin e ndërgjegjes kombëtare tek minoritetet e Krishtera të Perandorisë. Influenca e huaj ndikoi në forcimin e dallimeve burokratike midis të Krishterëve dhe Myslimanëve. Me fjalë të tjera: Nga njëra anë politikave të Perandorisë synonin centralizimin e shtetit, fshirjen e diferencave sektare dhe forcimin e ligjit, kurse nga ana tjetër vendet Europiane po shfrytëzonin influencën e tyre duke i promovuar më tej diferencat ekzistuese. Ligjërimi nëpërmjet të cilit fuqitë perëndimore synonin politizimin e diferencave ekzistuese ishte ai i zbulimit të “rrënjëve natyrore” të komuniteteve fetare në emër të të cilave duhet të luftonin për shkëputjen nga një Perandori etnikisht dhe kulturalisht heterogjene (Blumi: 2011, 103). Kështu shtetet Europiane në politikën e jashtme u shpallën si mbrojtës të grupeve të Krishtera brenda Perandorisë të cilat duhet ta harronin të shkuarën e tyre disa-shkullore në këtë shoqëri multi-fetare. Në lidhje me këtë çështje, studiuesi Ussama Makdasi do të shkruante se “Të kushtëzuara nga rrethanat e kohës, elitat lokale do të hynin në aleancë me fuqitë Europiane duke artikuluar një ligjërim progresi dhe civilizimi” (Makdasi: 2000, f. 92). Ky lloj ligjërimi mbi ‘civilizimin dhe progresin’ është në koherencë me orientalizmin, që është ndër konceptet kryesore ku fokusohet ky punim. Ishte pikërisht ky lloj ligjërimi që në fazat e mëtejshme u “ngjyros” me nuancat nacionaliste në periudhën e Rilindjes kombëtare. Nga ana tjetër, ishin prijet separatiste të kohës të mishëruara në figurën e

botës së civilizuar të Krishterë që do të sillnin centralizimin e shtetit Osman në kohë e reformave të Tanzimatit si rezistencë kundrejt ligjëritimit nacionalist dhe orientalist të minoriteteve. Është e rëndësishme që në mbyllje të kësaj pjese të theksohet se figura të rëndësishme të nacionalizmit shqiptar si Bushatllinjët e Shkodrës, Ali Pasha, Skënderbeu apo Mehmet Aliu ashtu sikurse figura të nacionalizmit serb të tilla si Obrenovici, në kontekstin e tyre nuk synonin zgjerimin e vendit të tyre përtej rajoneve ku ata qeverisnin. Isa Blumi na kujton se “atdheu” i Skënderbeut nuk shtrihet deri në Tivar apo në Prevezë, teksa Ali Pasha bashkëpunoi me elitat e Peloponezit në sulmin e tij kundër Gegëve të veriut të Shqipërisë në përputhje me politikën e Sulltanit (Blumi: 2011, 106). Në vazhdim të këtij kapitulli do të përpiqem të shpjegoj rëndësinë e hapjes së shkollave në kultivimin e identitetit kombëtar tek minoritetet e Perandorisë. Ndryshe nga pikëpamjet klasike sipas të cilës ishte ndërgjegjja kombëtare shqiptare që solli si rezultat luftën e vazhdueshme për hapjen e shkollave shqipe, do të argumentohet se në të vërtetë hapja e këtyre shkollave ishte në vazhdimësi të rritjes së influencës së fuqive Europiane në Perandorinë Osmane. Në këtë drejtim, do të shohim se si dialektika mes rritjes së centralizimit gjatë periudhës së Tanzimatit dhe rezistencës së brendshme të intelektualëve në rajone të ndryshme të Perandorisë solli si rezultat një elitë të shkolluar nëpër shkollat e Stambollit dhe të Janinës, që do t’i bënte rezistencë arsimimit masiv që po promovonte administrata e re Osmane.

Bibliografia

- Bartl P, Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912), Dituria, Tiranë 2006
- Blumi I, Reinstating the Ottomans, Palgrave MacMillan, New York 2006
- Clayer N, Në fillimet e nacionalizmit shqiptar: Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Europë, Tiranë: Përpjekja 2009
- Fortna B, Imperial classroom. Islam, the state and education in the late Ottoman Empire, Oxford University Press: 2002
- Frashëri S, Shqipëria çka qenë, ç’është e ç’do të bëhet? Mendime për shpëtim të mëmëdheut nga rreziqet që e kanë rrethuar, Tiranë 1962
- Georgeon F, Des Ottomans aux Turcs. Naissance d’une nation, Isis, Stamboll: 1995
- Hobsbaum E, Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780: program, miti, realiteti; Toena, Tiranë 2012
- Limthi L, Fjalët turkisht ose t’ardhuna në anën e turkishtes të përdorura në “Lahuta e Malcis”, Shtezjat 5, Tiranë: 1961
- Makdisi F, The Culture of Sectarianism: Community, History and Violence in Nineteenth-Century Ottoman Lebanon, University of California Press 2000
- Merxhani B, Vepra, Plejad, Tiranë 2003
- Pulaha S, Qëndresa e popullit shqiptar kundër sundimit Osman nga shek. XVI deri në fillim të shek. XVIII, dokumente Osmane, Tiranë 1978
- Vlora E, Bisedime mbi historinë bujqësore të Shqipërisë, Arkivi i Institutit të Historisë, Dosja A-VII-5, 55

NDRYSHIMET DHE VAZHDIMËSITË NË LIGJËRIMIN POLITIK TË LIDERËVE SHQIPTAR NDAJ KOSOVËS

DORINA NDOJ

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara

ABSTRAKT

Ky punim ka për qëllim të hulumtojë ndryshimet dhe vazhdimësitë në ligjërimin politik të liderëve shqiptar ndaj Kosovës përgjatë viteve 2008-2015. Ligjërimi konsiderohet si një instrument i rëndësishëm në përkufizimin e identitetit dhe interesave të një shteti, ashtu edhe në të kuptuarin e sjelljes së tij. Prandaj ky punim synon të identifikojë dhe analizojë çështjet dhe temat kryesore që janë prezente në ligjërimin politik lidhur me shtetin e Kosovës. Pyetjet kryesore kërkimore të punimit janë: Cili është ligjërimi dominant? Si trajtohet marrëdhënia me Kosovën në ligjërimin e liderëve shqiptar? Punimi synon të gjurmojë kuptimet që elita politike shqiptare, veçanërisht dy liderët kryesorë, kryeministri aktual, Edi Rama dhe ish kryeministri, Sali Berisha, i atribuojnë marrëdhënies dypalëshe me Kosovën. Punimi mbështetet në qasjen kontruktiviste të Analizës së Politikës së Jashtme, ndërkohë që metodologjikisht aplikon Analizën Kritike të Ligjërimit. Baza e të dhënave përfshin deklaratat, fjalime të elitës politike, konkretisht të dy liderëve kryesorë, të zyrtarëve të tjerë shqiptarë dhe të huaj, si dhe strategjitë e politikës së jashtme. Ai mbështet argumentin se duke luajtur me idenë e 'bashkimit kombëtar', në ligjërimin politik BE imponohet si një aktor prezent në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Kosovës. Por për sa kohë nuk kemi një rezonancë mes ligjërimit të liderëve politik [ligjërimin politik] për bashkim kombëtar dhe ligjërimin zyrtar të politikës së jashtme, nuk mund flasim për një stabilizim të një ligjërimi të tillë.

Fjalë kyç: *Ligjërimi Politik, Politika e Jashtme, Analizë Kritike Ligjërimi, Marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë.*

Hyrje

Marrëdhëniet dypalëshe Shqipëri-Kosovë janë shumë të rëndësishme si në planin dypalësh – jo vetëm për shkak të lidhjeve historike ndërmjet dy vendeve, por edhe për zhvillimin e tyre të përbashkët ekonomik e politik – ashtu edhe për stabilitetin e rajonit. Në shumë raste deklaratat e liderëve të këtyre dy vendeve janë bërë burim diskutimesh jo vetëm për publikun e brendshëm, por edhe burim tensioni në marrëdhëniet me vendet e tjera. Kjo ka ndodhur sa herë liderët shqiptar kanë artikuluar çështjen e ‘bashkimit të shqiptarëve’. Së fundmi kjo çështje u risoll në vëmendje të publikut në një intervistë të përbashkët për media “Klan Kosova”, të mbajtur më 4 Prill në Ulqin, të kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama dhe zv/kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi. Kryeministri Rama u shpresh se “bashkimi është diçka e pashmangshme dhe do të ndodhë në BE. Por mund të ndodhë në një formë tjetër nëse Europa nuk ndërhyr në kalkulimet strategjike të shteteve të Ballkanit...” (Rama, 4 prill 2015). Nisur nga kjo është me rëndësi hulumtimi i qëndrimeve/ligjërimin të liderëve të këtyre vendeve, si aspekt kyç në projektimin e vizionit të këtyre marrëdhënieve në të ardhmen.

‘Bashkimi i shqiptarëve’ është shndërruar në një nga temat më të shpeshta dhe më polemike në ligjërimin e liderëve shqiptar lidhur me Kosovën. Të kuptuarit e ‘bashkimit të shqiptarëve’ si ligjërim të politikës së jashtme lind nevojën për studimin e mënyrës sesi është artikuluar nga liderët politik dhe nëse mund të flasim për një ligjërim dominant dhe të stabilizuar. Kjo panoramë e marrëdhënieve dypalëshe shpeshherë është karakterizuar nga një gjuhë e dyfishtë, e cila krijon terren për interpretime të ndryshme. Nga njëra anë vlerësohet se “marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë janë të shkëlqyera e vëllazërore dhe se partneriteti strategjik mes dy shteteve tona është një instrument themeltar që përcakton dhe do të përcaktojë në vijimësi peshën e faktorit shqiptar në rajon” (Rama, 09 Mars 2015). Nga ana tjetër, në të njëjtën kohë duket se po zhvillohet një debat tjetër që lidhet me ‘bashkimin e shqiptarëve’, debat në të cilin janë përfshirë jo vetëm një pjesë e konsiderueshme e elitës politike dhe intelektuale në të dy vendet, por është shtrirë edhe në vende të tjera të rajonit në formën e reagimeve dhe shqetësimeve politike.

Ligjërimi politik është një burim kyç informacioni, i cili është i nevojshëm të analizohet në vetvete më shumë sesa të merret i mirëqenë. Ashtu si shumica e veprimeve dhe ngjarjeve politike konsiston në deklarata dhe fjalime, një pjesë e madhe e aktivitetit diplomatik ndodh në nivel ligjërimi. Një analizë ligjërimi e këtyre praktikave jo vetëm kontribuon në të kuptuarin e tyre, por gjithashtu në pasojat e mundshme lidhur me politikën e jashtme. Ky punim ka për qëllim të identifikojë ligjërimin dominant të liderëve shqiptarë lidhur me marrëdhëniet Shqipëri – Kosovë. Një hap domethënës në këtë drejtim, është kryerja e një studimi që pasqyron mënyrën se si liderët kryesorë të politikës – kryeministri aktual Edi Rama dhe ish kryeministri Sali Berisha - kanë formuluar diskursin politik rreth Kosovës, si dhe të evidentojë “temat” dhe “çështjet” dominante në ligjërimin e tyre. Pyetjet kryesore të punimit janë: Cili është ligjërimi dominant? Si trajtohet marrëdhënia me Kosovën? A ka ndryshime apo vazhdimësi në ligjërimin e liderëve shqiptar për marrëdhëniet dypalëshe Shqipëri-Kosovë? A ka ndryshime apo vazhdimësi në politikën e jashtme të Shqipërisë ndaj Kosovës? Konteksti ligjërimor, në nivel të brendshëm dhe të jashtëm, do të na vijë në ndihmë për të identifikuar dhe kuptuar çështjet kryesore në marrëdhëniet midis Shqipërisë e Kosovës dhe se si kjo ka formësuar identitetin, interesat dhe sjelljen e Shqipërisë në politikën e saj ndaj Kosovës. Punimi mbështet argumentin kryesor se duke luajtur me idenë e ‘bashkimit kombëtar’ në ligjërimin politik, BE imponohet si një aktor prezent në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Kosovës. Por për sa kohë nuk kemi një rezonancë mes ligjërimin të liderëve politikë [ligjërimin politik] për bashkim kombëtar dhe ligjërimin zyrtar të politikës së jashtme, nuk mund flasim për një stabilizim të një ligjërimi të tillë.

Modeli teorik dhe metodologjia

Politika e jashtme përgjithësisht ka mbetur jashtë objektit të qasjeve të analizës së ligjërimin. Kjo ka ardhur si rrjedhojë e fokusimit kryesisht në teoritë e mëdha të Marrëdhënieve Ndërkombëtare në studimin e politikës së jashtme dhe si i tillë ligjërimi nuk është trajtuar si një njësi e rëndësishme e analizës. Por në vitet e fundit ka patur një numër në rritje të studimeve që lidhin politikën e jashtme dhe qasjet e analizës së ligjërimin. Gjithnjë e më shumë metoda të tilla janë bërë pjesë e axhendave kërkimore të konstruktivistëve, post-strukturalistëve dhe studiuesve të teorive kritike.

Kontribute të rëndësishme në ndërlidhjen e politikës së jashtme dhe analizës së ligjërimin i gjejmë në veprat e autorëve të Shkollës së Kopenhagës si Lene Hansen (2002; 2006), Henrik Larsen (1997; 1999) dhe Ole Wæver (1996; 2002). Në punën e tij “*Foreign Policy and Discourse Analysis: France, Britain and Europe*”, Henrik Larsen (1997) prezanton analizën e ligjërimin politik si një qasje alternative ndaj politikës së jashtme, ku nëpërmjet një studimi të detajuar të ligjërimin britanik dhe francez rreth temave si Europa, siguria kombëtare/shtetërore dhe natyra e marrëdhënieve ndërkombëtare, ai demonstron rëndësinë e ligjërimin politik në formësimin e politikës së jashtme. Ndërkohë në veprën “*British and Danish European Policies in the 1990s: A Discourse Approach*”, ai argumenton se “dallimet në politikat europiane ndërmjet këtyre dy vendeve [Britanisë së Madhe dhe Danimarkës] janë formësuar nga kuptime të ndryshme të koncepteve të shtetit dhe kombit, kuptime të cilat kanë ndikuar përmbajtjen dhe procedurat e politikave të tyre” (1999:451). Ndërkohë që Wæver ndan me Larsen pikëpamjen se një analizë ligjërimi e politikës së jashtme duhet të shihet si përplotësuese e qasjeve të tjera (Wæver, 2002), nga ana tjetër Hansen (2006) i kushton rëndësi metodologjisë dhe ofron udhëzime për kërkimin e bazuar në analizë ligjërimi. Duke qënë e rrënjësor fort në një qasje post-pozitiviste, për këtë arsye analiza e diskursit është e vështirë të lokalizohet. Sipas Milliken (1999:225) “teorizimi i diskursit tejkalon dhe mikson ndarjet mes post-strukturalistëve, post-modernistëve, feministëve dhe konstruktivistëve shoqërore”.

Baza teorike e këtij punimi mbështetet në qasjen konstruktiviste të Analizës së Politikës së Jashtme e gërshetuar me aplikimin e Analizës Kritike të Ligjërimit. Konkretisht mbështetet në variantin europian të konstruktivizmit, shpesh i interpretuar post-pozitivist ose interpretativ, i cili e konsideron gjuhën si struktura kuptimi që bëjnë të mundur veprime politikash të jashtme të caktuara. Ato shqyrtojnë kushtet historike dhe ndërtimet gjuhësore (diskutimet shoqërore) që mundësojnë ndryshimin në politikën e një shteti. Sipas Hopf (2002) sjellja e politikës së jashtme mundësohet nëpërmjet këtyre ndërtimeve gjuhësore. Demirtas Bagdonas argumenton se “politikbërësit artikulojnë politikën e tyre (prezantojnë politikën të caktuar si pjesë e orientimit të përgjithshëm politik ose artikulojnë nevojën për t’u zhvendosur nga politikën tradicionale), dhe si e tillë analiza e ligjërimit është mjeti më i mirë për të studiuar platformat ideologjike të krijuara në ligjërimin e politikës së jashtme“ (2008:19).

Metodologjia e aplikuar është Analiza Kritike e Ligjërimit, fokusuar në punën e N. Fairclough, R. Wodak dhe T. Van Dijk. Nisur nga konsiderata e Waever (2004:198) për qasjet ligjërimore, ky punon e trajton Analizën Kritike të Ligjërimit njëkohësisht si metodologji dhe si qasje teorike. Studimet e mbështetura në analizë ligjërimit përdorin gjuhën si instrument, ku metodologjikisht përfshihet leximi dhe interpretimi i teksteve dhe fjalimeve të ndryshme. Analiza e ligjërimit përqendrohet në analizën e kuptimit të koncepteve të veçantë, të cilët strukturojnë dhe artikulojnë atë që thotë aktori. Duke e analizuar “ligjërimin/gjuhën si një praktikë sociale” (Fairclough & Wodak, 1997), ajo mund ta na vijë në ndihmë për të kuptuar temat/ çështjet kryesore në ligjërim politik lidhur me marrëdhëniet mes dy vendeve. Specifikisht, Analiza Kritike e Ligjërimit “fokuset në mënyrat sesi ligjërimi ruan, konfirmon, legjitimon, riprodhon dhe sfidon pushtetin dhe dominancën në shoqëri” (Van Dijk, 1988:953), si dhe thekson “sesi marrëdhëniet e pushtetit ushtrohen dhe negociohen në ligjërim“ (Wodak, 1996). Sipas Fairclough pushteti brenda ligjërimit ka të bëjë me ligjëruesit e fuqishëm, të cilët kontrollojnë dhe detyrojnë kontributet e ligjëruesve më pak të pushtetshëm (Fairclough 1989: 46). Metodologjikisht analiza do të kryhet rreth: a) përmbajtjes, çfarë thuhet ose veprohet: b) marrëdhënieve, pra marrëdhënieve sociale të njerëzve të përfshirë në ligjërim dhe c) subjekteve ose “roleve/pozicioneve” që njerëzit kanë/luajnë.

Metoda e përdorur është cilësore, çka nënkupton aplikimin e një strategjie kërkimore thellësisht induktive që kërkon të shpjegojë politikën e jashtme me metoda që përfshijnë një sërë teknikash gjuhësore. Ligjërimi politik identifikohet nga aktorët apo autorët (politikanët) që e kryejnë atë. Studimet e ligjërimit politik kanë të bëjnë me tekstet dhe bisedat e aktorëve politik. Sipas Titscher et al. (2000:32) një nga funksionet e teksteve është përfaqësimi, ku nëpërmjet këtij të fundit ne arrijmë të evidentojmë tipare të grupit dhe situatës që po analizohet. Në këtë punim analiza kryhet mbi një korpus tekstesh (deklarata dhe fjalime) kryesisht të kryeministrit aktual, Edi Rama, dhe ish kryeministrit, Sali Berisha, si dhe të zyrtarëve politikë, përgjithësisht të palës shqiptare, përfaqësues të shtetit dhe qeverisë, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe institucioneve të tjera zyrtare, pozitës dhe opozitës. Ky korpus materialesh përfshin deklarata të mbajtura nga përfaqësues shtetërorë në takime zyrtare ndërmjet dy palëve, nënshkrimin e marrëveshjeve apo në çdo lloj dalje të tyre publike. Duke qenë se periudha kohore që merr në shqyrtim ky punim është relativisht e gjatë, 2008-2015, fillimisht është bërë një kërkim paraprak për krijimin e një listë ngjarjesh. Kjo listë ka shërbyer në evidentimin e disa momenteve kryesore, në mënyrë që kërkimi të jetë më i orientuar dhe më lehtësisht i realizueshëm. Gjithashtu, gjurmimi paraprak i ngjarjeve kryesore ka shërbyer në evidentimin e disa koncepteve kryesore mbi çështjen, rreth të cilave do të ndërtohet analiza në fokus të punimit.

Analizë, interpretim të dhënash

Interpretimi i teksteve ballafaqohet me një sërë çështjesh metodologjike të tilla si mënyra e klasifikimit, përkufizimit të termave kryesore, marrëdhëniet strukturë-agjenci, qëllimeve të autorit dhe periodicitetit (Hughes, 2005:247-67). Referuar metodologjisë së shpjeguar më sipër, në këtë punim analiza e të dhënave është kryer rreth dy ndarjeve: 1) aktorëve/subjekteve të përfshirë dhe 2) temave/çështjeve/objektit dhe strategjive të argumentimit. Në linjë me ndarjen e parë janë analizuar:

Ligjërimi i dy liderëve kryesorë politik (kryeministri aktual dhe ish kryeministri), si në pushtet ashtu dhe në opozitë; b) Qëndrimet e zyrtarëve të tjerë të lartë, p.sh. Ministrit të Punëve të Jashtme, kreut të shtetit, etj; c) Qëndrimet e përfaqësuesve të shtetit të Kosovës; d) Qëndrimet dhe reagimet e palëve të treta, si vendet fqinje, BE, SHBA, etj. Ndërsa lidhur me temat kryesore janë analizuar qëndrimet/artikulimet ndaj: a) marrëdhënieve dypalëshe/me Kosovën; b) bashkimit kombëtar/BE.

Ndër gjetjet kryesore të punimit përmendim: Në nivel ligjërimit politik vëmë re një gjuhë të shumëfishtë, e cila krijon terren për interpretime të ndryshme në varësi të audiencave që iu drejtohet. Ka një ambiguitet të vazhdueshëm mes artikulimeve nga njëra anë për mbështetjen e Kosovës si shtet i pavarur dhe nga ana tjetër retorikës nacionaliste për bashkim kombëtar (e cila bie ndesh me të parën duke qenë i paqartë sesi projektohet në ligjërim). Nisur nga kjo evidentohet një ndërthurje e vazhdueshme e dy ligjërimeve dominante:

Marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë cilësohen si vëllazërore (bazuar në lidhjet kulturoro-historike). Kjo konstatohet qoftë në ligjërimin e dy liderëve, Ramës dhe Berishës, si edhe të çdo përfaqësuesi tjetër të Shqipërisë dhe Kosovës. Përtej marrëdhënieve ndërshtetërore, ato cilësohen si vëllazërore. Ndër cilësimet e veshura kësaj marrëdhënie përmendim: vëllazërore, unike, shumë të afërta, shumë të ngushta, të shkëlqyera. Po ashtu në ligjërimin politik nuk mungojnë deklaratat për intensifikim të marrëdhënieve dypalëshe nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të përbashkëta në shumë fusha (megjithëse praktika tregon se nuk ka rezultate konkrete dhe pozitive!). Risia në ligjërimin e Ramës (dhe programin të politikës së jashtme të qeverisjes së majtë) është artikulimi i Kosovës si partner strategjik. “Partneriteti strategjik mes dy vendeve tona është një instrument themelitar që përcakton rolin e faktorit shqiptar në rajon (...) qëllimi parësor dhe më i rëndësishëm i politikave të përbashkëta strategjike të dy

qeverive është përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve tanë, përmirësimi i cilësisë së të jetuarit në hapësirën tonë të përbashkët, ku administrimin e bëjnë dy shtete, por ku aspiratat dhe interesat janë absolutisht të përbashkëta“ (Rama, 09 mars 2015). Artikulimi i Kosovës si partner strategjik është prezent në ligjërimin e qeverisë aktuale në përgjithësi, si dhe në ligjërimin e politikës së jashtme në veçanti.

“Bashkimi i shqiptarëve” është një nga temat dominante në ligjërimin politik lidhur me Kosovën. Do ta konsideroja një “narrativë ambigue” idenë e bashkimit mes dy vendeve, ku të dy liderët kryesisht për qëllime të brendshme politike, ndërthurin deklaratat për bashkim kombëtar dhe bashkim në BE. Duke luajtur me idenë e ‘bashkimit’, BE imponohet si një aktor prezent në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Kosovës. Sipas Larsen “të kuptuarit e “Europës“ si një ligjërim dominant është instrumental dhe konflikti politik fillestar është ndërmjet nën-ligjëriemeve [sub-discourses] të këtij ligjërimi instrumental“ (1999:451). Në fakt ajo që është padiskutim prezente në ligjërimin politik në Shqipëri është integrimi europian dhe Europa. Kështu që ‘bashkimi i shqiptarëve’ mund të shihet si një nën-ligjërim, që në fakt i shërben meta-diskursit të Europës, ku kjo e fundit paraqitet si busulla për të ardhmen e këtyre marrëdhënieve. Bazuar në këtë logjikë ‘bashkimi kombëtar’ kthehet në një nën-ligjërim në varësi në nevojave dhe interesave të brendshëm politik, si dhe të ligjërimin dominant të Europës. Pikërisht për këtë arsye marrëdhëniet eventuale të Shqipërisë me BE-në ndikojnë edhe në ligjërimin e rastit ndaj Kosovës dhe bashkimit kombëtar. Vëmë re se sa më nacionalist bëhet ligjërimi politik, aq më shumë liderët shtojnë akuzat dhe kritikën në raport me BE-në.

Këto dy ligjërieme janë dominante dhe ndërthuren në ligjërimin e të dy liderëve. Por nga tjetër konstatojmë disa tipare në ligjërimin e liderëve respektivë.

Ligjërimi i Ramës dhe Berishës karakterizohet nga popullzimi dhe retorika nacionaliste. Marrëdhëniet me Kosovën konstatohen shumë të politizuara dhe për rrjedhojë në këtë situatë luhet me perceptimet e njerëzve. Tema e bashkimit kombëtar është risjellë nga të dy liderët herë pas here në ligjërimin publik në forma të ndryshme dhe në momente të veçanta, si shtimi i retorikës nacionaliste të Berishës në festimet e 100 vjetorit të pavarësisë ose deklaratat e Ramës në Ulqin dhe në mbledhjen e dytë të përbashkët mes dy qeverive. Për shkak të lidhjeve historiko-kombëtare të përbashkëta, marrëdhëniet me shqiptarët në rajon në përgjithësi dhe me shqiptarët e Kosovës në veçanti janë parë nga liderët shqiptarë si mundësi për të projektuar rolin e tyre për komunitetin e shqiptarëve në Ballkan. Për të realizuar këtë është luajtur shumë me idenë e ‘bashkimit kombëtar’ të prezantuar me një gjuhë ambigue dhe e paqartë. Në ligjërimin e Berishës shfaqet në formën “të bashkohemi me njëri tjetrin, të bashkohemi në Evropë/bashkimi më njëri tjetrin drejt Europës/shqiptarët nuk duhet të pushojnë së ndërtuari idealin e tyre më suprem, idealin e bashkimit kombëtar“, ndërkohë që në ligjërimin e Ramës evidentojmë narrativa si “kufiri ishte i djeshëm, e ardhmja s’ka kufij/ëndërr e vjetër/ta bëjmë bashkimin përmes rrugës së re/proces pa kthim, atë të bashkimit të të gjitha forcave dhe të bashkimit të të gjitha institucioneve tona drejt një qëllimi të përbashkët“.

Në lidhje me ndryshimet dhe vazhdimësitë në ligjërimin politik të këtyre liderëve mund të themi se një nga të përbashkëtat në ligjërimin e të dy liderëve është se tonet nacionaliste kanë ardhur në rritje tek secili prej tyre. Po të bëjnë një analizë të kontekstit të brendshëm, konstatojmë se kjo ka ndodhur ose në momente/data/ngjarje të rëndësishme kombëtare ose kushtet e konfliktit dhe ngërçit të brendshëm politik, si dhe situatave parazgjedhore. P.sh. në rastin e Berishës shohin një mbivendosje të këtyre dy dinamikave: (i) para dhe përgjatë festimeve të 100 vjetorit të pavarësisë dhe (ii) para zgjedhjeve të përgjithshme të 23 qershorit 2013. Në qoftë se në dhjetor të 2011, në një takim me studentët, Berisha [kryeministër në atë kohë] shprehej se “Kosova dhe Shqipëria janë dy shtete të pavarura dhe duhet të kenë dy administrata. Në projektin e bashkimit kombëtar, sot mendoj se interesi më i mirë i shqiptarëve është ruajtja e kufijve ekzistues“ (16 dhjetor 2011), pothuajse një vit më vonë përgjatë festimeve të 100 vjetorit të pavarësisë vëmë re një përmbyse të qëndrimeve të tij, më shtim të dozave nacionaliste në deklaratat e tij, duke kërkuar që “Askush të mos druhet, të mos irritohet nga përpjekjet e shqiptarëve për bashkimin e tyre kombëtar, se kjo synon përqendrimin, shpалosjen e energjive të tyre të pafundme, për të ndërtuar atë që u mungoi. Askush nuk duhet të harrojë se shqiptarët u takuan me shekullin e ri, të lirë, por si një komb që kishte mbijetuar si një komb që padrejtësitë e mëdha nuk e kishin lejuar të ndërtojë të ardhmen...” (Berisha, 25 nëntor 2012).

Sipas Bieber (2014) “Sali Berisha dështoi në përpjekjet e tij për të përdorur 100 vjetorin e shtetit shqiptar për mbijetesën e tij politike“. Edhe në rastin e kryeministrit aktual vëmë re një shtim të retorikës nacionaliste të ndërthurrur me kritikën ndaj BE-së. Në një intervistë të përbashkët me zv/kryeministrin e Kosovës, Hashim Thaçi, për media “Klan Kosova“, të mbajtur më 4 Prill në Ulqin, Kryeministri Rama u shpreh se “bashkimi është diçka e pashmangshme dhe do të ndodhë në BE. Por mund të ndodhë në një formë tjetër nëse Europa nuk ndërhyr në kalkulimet strategjike të shteteve të Ballkanit...” (Rama, 4 prill 2015). Sipas analistit Fatos Lubonja, në qoftë se deri tani Rama përdorte një gjuhë të dyfishtë (nacionaliste për shqiptarët dhe postnacionaliste për perëndimorët), në mbledhjen mes dy qeverive në Tiranë, ai filloi të përdorë një gjuhë të trefishtë. “Ai përdori disa tone të forta patriotike (...) U dallua qartë, pra, edhe një gjuhë e tretë për shqiptarët e Kosovës, pasi tashmë kryeministri ka marrë edhe rolin e babait të kosovarëve, të cilët i mendon se jo vetëm e kanë më të madhe dëshirën për bashkim, por kanë nevojë edhe për mbrojtjen e Shqipërisë mëmë nga padrejtësitë jo vetëm të serbëve, por edhe të perëndimorëve“ (Lubonja, 06 prill 2015).

Një ndër thyerjet e para është qëndrimi i ndryshëm kur janë në pushtet dhe kur janë në opozitë. Ligjërimi ndryshon kur liderët janë në pushtet ose në opozitë. Kur ata janë në pushtet, ligjërimi i tyre karakterizohet nga tipare dhe tone nacionaliste. Ndryshe ndodh kur janë në opozitë. P.sh. në ligjërimin e Ramës, kur ishte në opozitë, termat bashkim kombëtar apo Shqipëri e Madhe (referuar deklaratave të Berishës) artikuloheshin nga ai si politikë e vjetër. “Bashkimi kombëtar nuk vjen nga rrugët e vjetra të mllëfit destruktiv. Fantazmat e nacionalizmit turbofolk të së shkuarës s’kanë vend në rajonin tonë. Ta bëjmë bashkimin kombëtar përmes rrugës së re të Europës” (Rama, 14 dhjetor 2012). Të njëjtin formë ligjërimi e ndeshim edhe në rastin e Berishës në opozitë, i cili akuzon kryeministrin Rama për nacionalizmin e theksuar. Kujtojmë qëndrimin që mbajti ish kryeministri Sali Berisha lidhur me deklaratat e kryeministrit Edi Rama për Kosovën në vizitën e këtij të fundit në Beograd “Kosova e pavarur

ka përfaqësuesit e vet me legjitimitet kombëtar dhe ndërkombëtar dhe nuk mund të përfaqësohet nga një përfaqësues i Shqipërisë apo ndonjë vendi tjetër për interesat e saj në Beograd“ (Berisha, 15 janar 2014).

Në ligjërimin e Ramës vëmë re një “zgjatim/shtrirje të aspekteve jo-verbale të ndërveprimit dhe komunikimit (Wodak Meyer, 2008:02). Në rastin e tij, simbolika ka qënë mbizotëruese, duke nisur që me vizitën e tij të parë jashtë shtetit si kryeministër të cilën e zhvilloi në Kosovë ose përmendim praktikën e mbledhjeve qeveritare të përbashkëta, përzgjedhja e vendit dhe gjithë simbolikën që ka shoqëruar zhvillimin e tyre. Përmendim moton “një tokë, një popull, një ëndërr“ të mbledhjes së dytë të përbashkët qeveritare të mbajtur në Tiranë.

Zyrtarë të tjerë të shtetit shqiptar, kryesisht përfaqësues të MPI, shpeshherë u duhet të sqarojnë qëndrimet e liderëve të tyre, sidomos lidhur me temën e ‘bashkimit kombëtar’. Për sa kohë nuk kemi një rezonancë mes ligjërimin të liderëve politikë [ligjërimin politik] dhe ligjërimin zyrtar të politikës së jashtme, nuk mund flasim për një stabilizim të një ligjërimi të tillë. Vëmë re se në ligjërimin e ministrave të qeverisjes së majtë lidhur me çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet dypalëshe me Kosovën është prezente çështja e partnitetit strategjik, duke e bërë pjesë të ligjërimin zyrtar të politikës së jashtme.

Ndonëse në vitet e para pas pavarësisë së Kosovës përfaqësuesit e Kosovës mund të ishin në rezonancë me deklaratat e përfaqësuesve shqiptarë pas hyrjes në bisedime/dialog me Serbinë nën umbrellën e BE-së ligjërimi i tyre është bërë më i kujdesshëm, duke u shprehur më qartë (edhe si sqarim për deklaratat e liderëve shqiptar) se bashkimi do të ndodhë në kuadër të procesit të integritimit në BE. Kosova dhe përfaqësuesit e saj nuk përmendin “bashkim kombëtar” në deklaratat e tyre. Përmendim këtu qëndrimin e presidentes së Kosovës, Atifete Jahjaga, lidhur me deklaratat e Ramës në Ulqin “*sot jetojmë në kohën e integritimeve dhe prandaj integritet europian janë qëllimi dhe alternativa e të gjitha shteteve të Ballkanit. Kosova është një shtet i pavarur dhe sovran dhe si çdo shtet tjetër në rajon synon integritet europian dhe punon në përmbushjen e kriteve për anëtarësim në BE” (Jahjaga, 11 Prill 2015).*

Në moment të caktuara, ligjërimi i të dy liderëve lidhur me raportin Shqipëri-Kosovë ka shkaktuar reagime, shqetësim dhe kritika nga ana e BE-së, SHBA-së dhe vendeve të tjera të rajonit, veçanërisht të palës serbe. Ky reagim ndërkombëtar ka ardhur kryesisht si kundërpërgjigje ndaj deklaratave për ‘bashkim kombëtar të shqiptarëve’ të liderëve shqiptarë, e cila sipas tyre dëmton dhe cenon të ardhmen europiane të këtyre vendeve. Përfaqësuesit e BE-së apo SHBA-së paraqiten si ligjëruer të pushtetshëm, pasi pushtetin në trekëndëshin BE-Shqipëri-Kosovë qëndron pikërisht në vullnetin e tyre, ku perspektiva e integritet europian shndërrohet në një imperativë për formën e marrëdhëniesve Shqipëri-Kosovë.

Konkluzione/rekomandime

Punimi hulumtoi ndryshimet dhe vazhdimësitë në ligjërimin politik të liderëve shqiptar ndaj shtetit të Kosovës përgjatë viteve 2008-2015. Duke analizuar kontekstin ligjërimor bazuar në qasjen konstruktiviste dhe Analizën Kritike të Ligjërimin, punimi gjurmoi temat, çështjet dhe kuptimet që elita politike shqiptare, veçanërisht dy liderët kryesorë, kryeministri Edi Rama dhe ish kryeministri Sali Berisha, i atribuojnë marrëdhënies dypalëshe me Kosovën. Ndër gjetjet kryesore të punimit konstatojmë një ndërthurje e vazhdueshme të dy ligjëtimeve dominante: (i) Ligjërimi politik karakterizohet nga rezonanca kulturoro-historike, vëllazërore, kombëtare. Përtej marrëdhëniesve ndërshtetërore, marrëdhëniet dypalëshe me Kosovën cilësohen si vëllazërore dhe shumë të ngushta; (ii) “Bashkimi i shqiptarëve” është një nga temat dominante në ligjërimin politik lidhur me Kosovën, ku të dy liderët kryesisht për qëllime të brendshme politike, ndërthurin deklaratat për bashkim kombëtar dhe bashkim në BE. Punimi mbështet argumentin kryesor se duke luajtur me idenë e ‘bashkimit kombëtar’ në ligjërimin politik, BE imponohet si një aktor prezent në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Kosovës. Në përgjithësi ekziston një ambiguitet i vazhdueshëm [deri diku kontradiktore] mes artikulimeve nga njëra anë për mbështetjen e Kosovës si shtet i pavarur dhe nga ana tjetër retorikës nacionaliste për bashkim kombëtar (i cili bie ndesh me të parën duke qënë i paqartë sesi projektohet në ligjërim). Por për sa kohë nuk kemi një rezonancë mes ligjërimin të liderëve politikë [ligjërimin politik] për bashkim kombëtar dhe ligjërimin zyrtar të politikës së jashtme, nuk mund flasim për një stabilizim të një ligjërimi të tillë.

Bibliografia

- Bieber, F. (2014). Greater Serbia and Greater Albania do not exist: The myth of bad Serb-Albanian relations. *Balkans in Europe Policy Blog*. Marrë nga: <http://www.suedosteuropa.uni-graz.at/biepag/node/113> [Parë për herë të fundit më 10 Prill 2015]
- Berisha, S. (15 Janar 2014). Berisha: Rama s'ka mandat për te diskutuar ne Beograd për Kosovën. Kohërat e Hoxhës kane marr fund! *Gazeta Panorama*. Marrë nga: <http://www.panorama.com.al/berisha-rama-nuk-ka-mandat-per-te-diskutuar-ne-beograd-per-kosoven-koherat-e-hoxhes-kanemarr-fund/> [Parë për herë të fundit më 28 Mars 2015]
- Demirtas, B. O. (2008). A Poststructuralist Approach to ideology and Foreign Policy: Kemalism in the Turkish Foreign Policy Discourse. Phd Thesis. Marrë nga: <file:///C:/Users/User/Downloads/iphdeo01.pdf> [Parë për herë të fundit më 28 Mars 2015]
- Fairclough, N. L. & Wodak, R. (1997). Critical discourse analysis. In T. A. van Dijk (ed.), *Discourse Studies. A Multidisciplinary Introduction*, Vol. 2. Discourse as Social Interaction. London: Sage.
- Fairclough, N. (1989). *Language and Power*. New York: Longman, Inc.
- Fairclough, N. (1992). *Discourse and Social Change*. Cambridge: Polity Press.
- Hughes, C. R. (2005). Interpreting nationalist texts: a post-structuralist approach. *Journal of contemporary China*, 14 (43). pp. 247-67.
- Larsen, H. (1999) ‘British and Danish European policies in the 1990’s: A discourse approach’ *European Journal of International Relations* Vol. 5(4): 451–483.

- Larsen, H. (1997) *Foreign Policy and Discourse Analysis: France, Britain and Europe*. London: London School of Economics and Political Science / Routledge.
- Rama, E. (9 Mars 2015). Partneriteti strategjik Shqipëri-Kosovë instrument për peshën e faktorit shqiptar në rajon. Marrë nga: <http://www.kryeministria.al/al/newsroom/deklarata-per-shtyp/partneriteti-strategjik-shqiperi-kosove-instrument-per-peshen-e-faktorit-shqiptar-ne-rajon1425909038&page=1> [Parë për herë të fundit më 10 Prill 2015]
- Rama, E. (16 Dhjetor 2014). Rama: Shqipëria dhe Kosova, shembull i gjallë i një integrim te merituar ne BE. *Gazeta Shqiptarja.com* Marrë nga: <http://shqiptarja.com/lajme%20shkurt/2749/rama-shqip-ria-dhe-kosova-shembulli-i-gjall--i-nj--integrimi-t--merituar-n--be-260011.html#sthash.IW4jJqK.dpuf> [Parë për herë të fundit më 15 Prill 2015]
- Titscher, S. et al (2000). *Methods of Text and Discourse Analysis*. London: Sage.
- Van Dijk, T. A. (2005). Critical Discourse Analysis. In Schifffrin, D., Tannen, D., & Hamilton, H. E. (Eds.). *The Handbook of Discourse Analysis*. Oxford: Blackwell Publishers Ltd.
- Wæver, O. (2002). "Identity, communities and foreign policy: discourse analysis as foreign policy theory" in Hansen, L., & Wæver, O. (eds). *European Integration and National Identity. The challenge of the Nordic States*. London and New York: Routledge.
- Wodak, R., & Meyer, M. (2008). *Critical Discourse Analysis: History, Agenda, Theory and Methodology*. Marrë nga: http://www.corwin.com/upm-data/24615_01_Wodak_Ch_01.pdf [Parë për herë të fundit më 20 Mars 2015]

ANALIZË E SIGURISË ENERGETIKE NË SHQIPËRI NËPËRMJET NJË QASJE MULTIDIMENSIONALE

FATRI MORINA

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale & Edukimit

PËRPARIM FUGA

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale & Edukimit

ABSTRAKT

Energjia luan një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e një vendi, prandaj furnizimi i përballueshëm dhe i besueshëm me energji janë thelbësor për këtë zhvillim. Bazuar në rëndësinë e sigurisë energjetike [disponueshmëria e qëndrueshme e burimeve energjetike me një çmim të favorshëm], ajo duhet të jetë pjesë e prioriteteve kryesore të një vendi. Vetëm një qasje e integruar, e cila kombinon të gjitha dimensionet e sigurisë energjetike, mund të jetë një mënyrë e efektshme për garantimin e sigurisë energjetike. Siguria energjetike është një koncept multidimensional, e cila përfshin dimensione të brendshme e të jashtme dhe mund të analizohet nga niveli kombëtar në atë rajonal dhe global.

Qëllimi i këtij punimi është analizimi i sektorit të energjisë në Shqipëri, me fokus në dimensionet ekonomike, sociale, mjedisore dhe teknike të sigurisë energjetike. Sektori i energjisë në Shqipëri karakterizohet nga një infrastrukturë problematike, efikasitet i ulët, varësi e lartë dhe nivel i ulët i diversifikimit të burimeve, element të cilët kanë impakt të drejtpërdrejtë në sigurinë energjetike. Të dhënat e përdorura në këtë punim bazohen në të dhënat e Bankës Botërore, Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë, Fondit Monetar Ndërkombëtar, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, ERE dhe INSTAT.

Fjalë kyç: *Siguri energjetike; qasje multidimensionale; Shqipëri.*

Hyrje

Zhvillimi dhe rritja ekonomike e një vendi është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me garantimin e një furnizimi të qëndrueshëm me energji, e cila nevojitet të përdoret në mënyrë të efektshme, duke kufizuar emetimin e karbonit dhe mbrojtjen e mjedisit. Trashëgimia e një ekonomie të planifikuar dhe të centralizuar, me çmime të ulëta në mënyrë artificiale e kombinuar me një infrastrukturë jo efikase janë element të cilët kanë penguar vendet në tranzicion në rrugën e tyre drejtë garantimit të furnizimit të qëndrueshëm me energji. Një sërë masash janë marrë për të kapërcyer këtë situatë, por mbetet akoma shumë punë për të bërë me qëllim përafrimin me standardet ndërkombëtare për një energji efikase, zhvillimin e burimeve të rinovueshme të energjisë dhe politikave që adresojnë ndryshimet klimaterike. Faktori themelor për garantimin e furnizimit të qëndrueshëm me energji është ndryshimi sistemik, zëvendësimi i infrastrukturës së vjetër nuk është i mjaftueshëm. Efektiviteti i projekteve ose iniciativave specifike varen nga cilësia e institucioneve, kuadri ligjor dhe natyra e tregjeve (liberalizimi i tregut, taksa e karbonit, tarifa reflektuese të kostos etj.).

Qëllimi i këtij punimi është analizimi i sektorit të energjisë në Shqipëri, me fokus në dimensionet ekonomike, sociale, mjedisore dhe teknike të sigurisë energjetike. Sektori i energjisë në Shqipëri karakterizohet nga një infrastrukturë problematike, eficientë e ulët, varësi e lartë dhe nivel i ulët i diversifikimit të burimeve, element të cilët kanë impakt të drejtpërdrejtë në sigurinë energjetike. Shqipëria, si një vend në tranzicion, karakterizohet nga të gjitha problematikat e mësipërme duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në nivelin e sigurisë energjetike dhe implikimet e saj multi sektoriale. Duke qenë se siguria energjetike është një çështje komplekse e cila përfshin shumë faktor, për të analizuar atë është e nevojshme përdorimi i një qasje multidimensionale, ku të përfshihen si dimensionet socio-ekonomike ashtu dhe ato politike dhe mjedisore. Fillimisht është e nevojshme të paraqesim një përmbledhje të shkurtër të literaturës lidhur me sigurinë energjetike.

Rishikimi i literaturës dhe metodologjia e punimit

Ekziston një literaturë voluminoze lidhur me sigurinë energjetike, e cila trajton një sërë aspektesh, faktorësh, dimensionesh dhe implikimesh. Një ndër problematikat kryesore që vihet re gjatë shqyrtimit të literaturës është mungesa e një përkufizimi të gjithë pranuar lidhur me konceptin e sigurisë energjetike. Larmiteti i përkufizimeve lidhet me këndvështrimin dhe interesat e aktorëve të ndryshëm të cilët e trajtojnë këtë çështje, qofshin ato nga sfera akademike, politike apo teknike. Ebinger e thekson një fakt të tillë që në titullin e punimit të tij; *'The Meaning of Energy Security Depends on Who You Are'*, dhe përkufizon sigurinë energjetike si “aksesin e sigurt në burimet e nevojshme të energjisë me një çmim të përballueshëm, akses i cili duhet të jetë indiferent ndaj ndërprerjeve – pasi burimet alternative të furnizimit duhet të jenë në dispozicion me një çmim të përballueshëm dhe në sasi të mjaftueshme” (Ebinger, 2011, Paragrafi I). Vendet, në bazë të raportit të tyre me burimet energjetike, klasifikohen në vende konsumatorë, prodhues dhe transit të energjisë. Kjo është një ndarje standarde, pasi shtete të caktuara mund të kombinojnë element të kategorive të ndryshme. Këto elemente përcaktojnë dhe kuptimin që aktorët kanë lidhur me sigurinë energjetike. Përtej kësaj problematike, ndër përkufizimet më të përhapura është ai i dhënë nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë, e cila i referohet sigurisë energjetike si ‘disponueshmëria e pandërprerë e burimeve të energjisë me një çmim të vulltshëm’ (IEA, 2011). Vendet e Ballkanit përgjithësisht dhe Shqipëria veçanërisht karakterizohen nga kombinimi i elementëve të ndryshme të kategorive të sipërcituara.

Metodologjia e këtij punimi, kombinon element të qasjes cilësore dhe asaj sasore të kërkimit shkencor. Nëpërmjet përdorimit të të dhënave parësore dhe atyre dytësore, punimi mbështetet në një analizë multidimensionale të sigurisë energjetike. Fillimisht identifikohen dimensionet kryesore të sigurisë energjetike të cilat aplikohen më pas në kontekstin shqiptar. Dimensionet kryesore që trajtohen janë specifikuat: dimensionin ekonomik, social, mjedisor dhe teknik të sigurisë energjetike. Modeli kërkimor i përdorur në këtë punim është ai i një rasti studimor. Metodologjia lidhet në këtë mënyrë me qëllimin e punimit i cili është: analizimi i sektorit të energjisë në Shqipëri me fokus në dimensionet e sigurisë energjetike.

Analiza e gjetjeve

Sektori i energjisë në Shqipëri karakterizohet nga një infrastrukturë problematike, eficientë e ulët, varësi e lartë dhe nivel i ulët i diversifikimit të burimeve, element të cilët kanë impakt të drejtpërdrejtë në sigurinë energjetike. Kjo situatë shoqërohet me implikime multidimensionale, me efekt jo vetëm në nivelin e sigurisë energjetike por ndikon në perspektivën e zhvillimit dhe prosperitetit ekonomik e social të Shqipërisë.

Dimensioni ekonomik i sigurisë energjetike përbëhet nga element të shumtë të cilët variojnë që nga kostoja e blerjes/prodhimit të energjisë e deri tek fatura financiare e konsumatorit fundor të këtij produkti. Duke qenë se Shqipëria karakterizohet nga një nivel i lartë i varësisë energjetike dhe humbje të shumta të natyrës teknike dhe jo teknike, kostoja sa vjen dhe rritet. Duke pasur në konsideratë nivelin e zhvillimit ekonomik në Shqipëri, atëherë rritja e kostove prek ekonominë si në nivel kombëtar ashtu dhe atë individual/familjar. *Dimensioni social* është ngushtësisht i lidhur me dimensionin ekonomik. Nëse aktorët ndikohen drejtpërdrejt nga rritja e kostove, atëherë kushtet e tyre sociale do të ndikohen njëkohësisht. Kanalizimi i të ardhurave drejtë përballimit të kostove të rritura nënkupton kufizimin e shpenzimeve lidhur me aspektet sociale. *Dimensioni mjedisor* është një tjetër dimension i rëndësishëm kur analizohet niveli i sigurisë energjetike në Shqipëri. Duke qenë se burimi i prodhimit të

energjisë bazohet tek burimet hidrike, atëherë shfrytëzimi i lumenjve ndikon në balancat ekologjike të zonave ku ndërtohen hidrocentralet por dhe më tej. Ndërtimi i HEC-eve të vegjël në kaskadat e lumenjve ndikon në ekosistem. Për më tepër, duke qenë se prodhimi i energjisë bazohet në burimet hidrike, kjo nënkupton varësinë e lartë ndaj kushteve klimaterike. Periudhat e thatësirës shoqërohen me uljen e prodhimit vendas dhe rritjen e importit, e përkthyer në rritje të kostove të furnizimit me energji. Dimensioni teknik i sigurisë energjetike lidhet me kapacitetet infrastrukturore për prodhimin, shpërndarjen dhe përdorimin e energjisë. Kapacitetet e kufizuara infrastrukturore në rastin e Shqipërisë ndikojnë në nivelin e ulët të sigurisë energjetike. Humbjet teknike zënë një vend të konsiderueshëm në humbjet totale në rrjet. Shpërdorimi i energjisë, mungesa e termoizolimit dhe linjat e vjetëruara ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në sigurinë energjetike.

Shqipëria shfaqet si vendi me varësinë më të lartë nga importet, e llogaritur në rreth 65 % dhe me normën më të ulët të konsumit të energjisë elektrike për frymë, e cila llogaritet në vetëm 1980 kwh. Së bashku me Maqedoninë, janë të vetmet shtete në rajonin e Ballkanit të cilët nuk janë eksportues të energjisë elektrike. Sistemi energjetik në Shqipëri është relativisht i vogël, me një prodhim të elektricitetit të bazuar në burimet hidrike. Për shkak të konsumit të lartë dhe në rritje, edhe importi i energjisë elektrike është i lartë si pasojë e mos plotësimit të kërkesës nga burimet e brendshme energjetike. Investimet e kufizuara në sektorin e energjisë dhe humbjet e mëdha në rrjet, bëjnë që garantimi i sigurisë energjetike për Shqipërinë të jetë i vështirë dhe i kushtueshëm. Në këtë situatë, është i domosdoshëm vazhdimi i reformimit të sektorit energjetik dhe përmirësimi i furnizimit me energji. Diversifikimi i burimeve energjetike dhe reduktimi i varësisë nga elementët klimaterik janë çështje për të cilat duhet të tregohet një kujdes i veçantë. Një siguri energjetike e kërcënuar dhe nevoja për shtimin e importeve ka implikim të drejtpërdrejtë në çdo sektor të ekonomisë, pasi ndikon në buxhetin e shtetit në tërësi. Ndërtimi i HEC-ve të vegjël, përmirësimet në rrjetin e transmetimit dhe përpjekjet e vazhdueshme për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike janë disa elemente pozitive, por të cilët nuk kanë arritur të zgjidhin problematikën e energjisë në Shqipëri (Morina & Fuga, 2014).

Nëse ju referohemi statistikave që raporton Enti Regullator i Energjisë (ERE), Banka Botërore, Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë, por edhe INSTAT-i, Shqipëria ka një kapacitet të instaluar të prodhimit të energjisë elektrike prej rreth 1800 MW, nga të cilat rreth 1500 MW nga burimet hidrike, ndonëse në shfrytëzim realisht janë edhe më pak. Mbi këtë bazë, Shqipëria ka prodhimin e saj të energjisë elektrike, kryesisht nga burime hidrike, i cili në varësi të kushteve klimatike është luhatur nga vlera më e ulët prej 2.9 TWh në vitin 2007 në vlerën më të lartë prej 7.9 TWh në vitin 2010, duke dëshmuar qartë ndikimin e kushteve klimatike në prodhimin e energjisë në vend. Gjatë viti 2012 ky prodhim arriti në rreth 5.5 TWh, ndërkohë që kërkesa për konsum ka qenë atë vit rreth 7 TWh. Gjatë vitit 2012 kanë munguar rreth 2 TWh ndaj kërkesës për energji elektrike në vend, që është përbulluar me import. Lidhur me konsumin e energjisë elektrike, dihet se ka një lidhje, një raport të drejtë mes energjisë së prodhuar, energjisë së konsumuar dhe prodhimit të përgjithshëm vendas (GDP). Nëse krahasojmë kapacitetet prodhuese, rezulton se vendet me zhvillim të ulët, me GDP rreth 3000 euro/banorë, kanë një fuqi të instaluar të prodhimit të energjisë elektrike prej rreth 0.8 kW/banorë. Ndërkohë, vendet me GDP rreth 6000 euro/banorë, kanë një kapacitet të instaluar të prodhimit të energjisë elektrike prej rreth 1 kW/banorë. Vendet e rajonit të Europës Juglindore, GDP e të cilave luhaten nga 6000 deri në 9000 euro/banorë, kanë kapacitet të instaluar të prodhimit të energjisë elektrike rreth 1 kW/banorë. Shqipëria ka një GDP përafërsisht të po këtij niveli, ndërsa referuar popullsisë së saj prej 3 milion banorësh, kapaciteti i instaluar i saj rezulton të jetë rreth 0.5 kW/banor, shumë më i ulët edhe se ai i vendeve të pazhvilluara.

Përfundime

Sistemi energjetik në Shqipëri, i cili bazohet kryesisht në burimet hidrike është relativisht i vogël por me problematika të mëdha. Për të analizuar situatën e sektorit të energjisë në Shqipëri, punimi u mbështet në një analizë multidimensionale; dimensionin ekonomik, social, mjedisor dhe teknik. Njëpërmjet studimit identifikohen një sërë problematikash të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në nivelin e sigurisë energjetike, problematika të lidhura me kostot e larta, problemet infrastrukturore, mungesa e diversifikimit të burimeve dhe varësia e lartë. Të gjendur përballë kësaj situate, është e domosdoshme që aktorët shtetëror dhe jo shtetëror fillimisht të ndërgjegjësohen për rëndësinë e sigurisë energjetike për zhvillimin dhe prosperitetin e vendit, dhe të merren masa në këtë drejtim. Masat e marra së fundi janë kryesisht masa të natyrës afatshkurtër dhe afatmesme, por garantimi i sigurisë ka nevojë për marrjen e masave afatgjata nëpërmjet hartimit dhe implementimit të strategjive vizionare dhe realiste.

Bibliografia

- Baumann, F. (2008). Energy Security as multidimensional concept. *CAP Policy Analysis*
- Ebinger, C. (2011). 'The Meaning of Energy Security Depends on Who You Are'. *Brookings*. Faqja zyrtare e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë (www.ica.org).
- Faqja zyrtare e INSTAT (www.instat.gov.al)
- Faqja zyrtare e OSHEE (www.oshee.al)
- METE. (2003) Strategjia Kombëtare e Energjisë.
- METE. (2012) Strategjia Kombëtare e Energjisë, 2013-2020 (draft).
- Morina, F., & Fuga, P. (Spring 2014). Një Qasje Analitike mbi Sigurinë Energjetike në Ballkan. *Economicus*

APLIKIMI I DËNIMIT PENAL ME GJOBË NË SHQIPËRI.VËSHTRIMTEORIKO-PRAKTIK

ALEKS NIKOLLI

Universiteti Europian i Tiranës, Shkolla Doktorale, E drejtë Penale
alnikolli@live.com

ABSTRAKT

Dënimi me gjobë parashikohet si një nga dënimet kryesore në kodin penal të Republikës së Shqipërisë, por zbatimi i tij në praktikën gjyqësore është inferior në raport me dënimin me burgim. Shumë vende të Evropës perëndimore ndër të cilat Gjermania dhe vendet nordike kanë disa dekada të cilat aplikojnë me sukses dënimin me gjobë për vepra penale me rrezikshmëri jo shumë të lartë shoqërore. Për një drejtësi penale më të drejtë dhe të prekshme dhe për një sukses më të madh të realizimit të qëllimit të dënimin penal, shumica e këtyre vendeve kanë adaptuar sistemin e gjobave ditore. Ky punim ka për qëllim analizimin me një qasje kritike të çështjes së caktimit të dënimin me gjobë në vendin tonë nën dritën e eksperiencave më të mira të vendeve evropiane dhe të vetë problemeve të evidentuara në praktikën gjyqësore shqiptare. Për paraqitjen e një panorame sa më objektive të aplikimit të dënimin me gjobë në vendin tonë punimi mbështetet në metoda sasiore përmes analizimit të të dhënave dytësore të publikuara nga Ministria e Drejtësisë dhe më tej përmes vëzhgimit të një kampioni të madh vendimesh gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga ky studim rezulton se megjithëse neni 34 i Kodit penal është ndryshuar disa herë nga Legjislatori, përsëri ai është larg standardeve të vendeve të zhvilluara të Evropës perëndimore, pasi nuk arrin ti përgjigjet nevojës për një të drejtë penale humane, të drejtë dhe efektive në reduktimin e kriminalitetit.

Fjalë kyç: *dënim penal, gjobë penale, përfrim legjislacioni, gjobë ditore, caktim dënimi*

Hyrje

Dënimi me gjobë është një nga llojet e sanksioneve ekonomike (Miethë and Lu, 2005, f. 53), të cilat shteti i përdor për luftimin e fenomeneve të paligjshme. Megjithëse qëllimet që ndjek dënimi me gjobë janë përgjithësisht të njëjta me qëllimet që ndjekin sanksionet e tjera klasike, përsëri natyra e tij e diferencon në disa drejtime. Kështu dënimi me gjobë plotëson qëllimin shpagues, parandalues dhe restaurues të dënimit penal, por nuk mund të thuhet se ai plotëson qëllimin e pamundësisë (incapacitation) të dënimit me burgim. Megjithëse paraqitja e tij në format më të para daton që në antikitet (Halili, 2014, f. 93), vlera dhe përhapja e tij në shoqëritë moderne ka marrë një përhapje dhe aplikim shumë më të gjerë.

Pavarësisht se dënimi me gjobë njihet nga të gjitha familjet e sistemeve ligjore, shkalla dhe natyra e aplikimit të tij varijon nga sistemi në sistem. Kështu megjithëse dënimi me gjobë për vepra jo shumë të rënda është një praktikë e zakonshme e vendeve të zhvilluara perëndimore (Morris & Tonry, 1991, f. 32) në vendet e të drejtës islamike pagesa e një dënimi me gjobë ndaj familjarëve të viktimës mund të bëjë që gjykata të revokojë dënimin me vdekje të autorit të vrasjes (Miethë dhe Lu, 2005, f. 55). Edhe brenda vetë vendeve të zhvilluara ka dallime të dukshme në lidhje me shkallën e aplikimit të dënimit me gjobë. Gjohat ditore (të njohura në anglisht si “day fines”) janë një praktikë e përhapur gjerësisht në të drejtën penale të shumicës së vendeve të Europës perëndimore, si atë Gjermane, Austriake, Franceze, Suedeze, Daneze, Finlandeze (Kantorowicz, 2015, f. 26) etj. Gjithsesi, nga ana tjetër aplikimi i saj i gjerë ka ndeshur në vështirësi në disa vende të tjera të zhvilluara si Anglia, Australia apo Hungaria (Terance et al, 2005, f. 55). Dominimi i aplikimit të dënimit me gjobë ka rënë jo vetëm për shkak të problemeve të manifestuara gjatë aplikimit të tij në praktikë, por edhe si rezultat i shtimit të alternativave të tjera të dënimit me burgim (Albrecht, 2012, f. 33). Nëse para viteve '70 të shekullit të kaluar burgimi ka qenë alternativa e vetme e dënimit me gjobë, aktualisht gjykata ka një hapësirë më të gjerë zgjedhjeje në përshtatje me rrethanat konkrete të kryerjes së veprës dhe të vetë autorit.

Në nenin 29 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë dënimi me gjobë parashikohet si një nga dënimet kryesore për krimet dhe për kundërvajtjet penale. Dënimi me gjobë parashikohet aktualisht në K. Penal shqiptar si dënim i vetëm apo alternativ i dënimit me burgim në 194 nene të pjesës së posaçme të tij.

Prej disa vitesh Shqipëria po përballlet me një rëndim të situatës së mbipopullimit të burgjeve, e nxitur kjo nga një politikë e ashpër penale dhe nga një frymë politike dhe mediatike pro burgimit (Nikolli, 2015, f. 32). Kjo situatë ka bërë më imediate çështjen e eksplorimit të alternativave më moderne të burgimit, të cilat jo vetëm na afrojnë me standardet europiane, por përbëjnë dhe një zgjidhje më të zgjuar për çështjet e mbipopullimit të burgjeve, të uljes së kostove ekonomike dhe njerëzore të privimit të lirisë dhe pse jo edhe për një proces më të suksesshëm rehabilitues të personave të dënuar.

Një prej këtyre alternativave të cilat në mjaft vende kanë rezultuar të suksesshme është dhe sigurimi i një hapësire më të gjerë të aplikimit të dënimit me gjobë. Sipas autorëve Ismet Elezi, Skënder Kaçupi dhe Maksim Haxhia, (2013, f. 236), për nga shtrirja e tij dënimi me gjobë del në plan të parë në raport me të gjitha llojet e tjera të dënimeve. Gjatë këtij punimi do të përqipemi të analizojmë nëse një konstatim i tillë është i bazuar si në aspektin normativ ashtu edhe në atë aplikativ të praktikës gjyqësore. Studimi mbështetet nga njëra anë në një trajtim krahasues të legjisllacionit penal shqiptar me disa nga legjisllacionet bashkëkohore europiane në lidhje me dënimin me gjobë dhe nga ana tjetër në një analizë empirike të praktikës gjyqësore shqiptare në përzgjedhjen e këtij lloji dënimi.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Ky punim ka për qëllim që të eksplorojë dhe analizojë kuadrin ligjor të dënimit me gjobë në të drejtën penale shqiptare dhe problematikën e ndeshur gjatë aplikimit të tij në praktikë nga gjykatat e vendit. Studimi synon të analizojë përshtatshmërinë e kuadrit ligjor penal shqiptar me standardet europiane në lidhje me dënimin me gjobë dhe nga ana tjetër të eksplorojë tendencën e praktikës gjyqësore në aplikimin e këtij dënimi. Përmes analizimit të dënimit me gjobë në këto dy aspekteve, studimi synon të evidentojë të metat dhe deformimet dhe të përpiket të propozojë disa ndryshime ligjore dhe në jurisprudencës gjyqësore.

Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Pyetjet kryesore që përshkojnë punimin janë përcaktimi i rolit të dënimit me gjobë në të drejtën tonë penale në raport me dënimet e tjera penale dhe së dyti analizimi nëse kuadri ligjor shqiptar i cili e definon këtë pozitë dhe zbatimi i tij në praktikën gjyqësore, janë në harmoni me standardet europiane dhe me nevojën për një të drejtë penale të arsyeshme dhe humane.

Analizimi dhe shtjellimi i problemit të këtij studimi kalon nëpër një fazë teorike dhe një fazë të analizës empirike. Aspekti teorik i studimit mbështetet përgjithësisht në analizën e germës së ligjit dhe doktrinën vendase të së drejtës penale, politikës penale dhe të penalogjisë, ndërsa për krahasimin e saj janë shqyrtuar legjisllacionet penale të disa vendeve europiane si Gjermanisë, Finlandës, Suedisë, Danimarkës, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar, Francës, Greqisë dhe Maqedonisë. Nga aspekti empirik, studimi mbështetet fillimisht në analizën e të dhënave dytësore të publikuara nga Ministria e Drejtësisë në vjetarët statistikorë 2012 dhe 2013 të cilat japin një informacion më të gjerë mbi aplikimin e dënimit me gjobë në vendin tonë. Për shtjellimin më të thellë të pyetjes kërkimore, është vëzhguar më tej një kampion vendimesh gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë me të pandehur që janë deklaruar fajtorë për kryerjen e disa veprave penale me një përhapje të gjerë në praktikën

gjyqësore shqiptare. Me qëllim analizimin e diskrecionit gjyqësor në përzgjedhjen e llojit të dënimit me gjobë dhe më pas të masës së saj janë përzgjedhur disa figura veprash penale me një rrezikshmëri jo shumë të lartë shoqërore, të cilat e parashikojnë dënimin me gjobë si alternativë të dënimit me burgim. Veprat penale të tilla janë „Kanosja“, (neni 84 i K. Penal), „Plagosja e lehtë me dashje“, (neni 89), „Vjedhja“, (neni 134/1), „Vjedhja e energjisë elektrike“, (neni 137), „Mashtrimi“, (neni 143/1), „Mashtrimi në sigurime“, (neni 145), „Ushtrimi i palicencuar i lojërave të fatit“, (neni 197), „Ndërtimi i paligjshëm“ (neni 199/a.1), „Prishja e qetësisë publike“, (neni 274), „vetëgjyqësia“ (neni 277), „Mbajtja pa leje e armëve luftarake“, (neni 278/2), dhe „Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt“, parashikuar nga neni 291/1 i K. Penal.

Për shkak të aktualizimit të këtij studimi përzgjedhja e këtyre vendimeve është shtrirë për vitet 2012, 2013, dhe 2014. Kampioni i vendimeve është marrë nga arkiva e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nisur nga fakti se ajo është gjykata më e madhe në vend dhe që shqyrton rreth 25 % të çështjeve penale në rang vendi. Kështu gjatë vitit 2012, nga 8 679 të dënuar në shkallë vendi, 2143 ose 24.7 % janë dënuar vetëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Ministria e drejtësisë, 2012; f. 55), ndërsa në vitin 2013 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë dënuar 2178 persona, nga 8 578 persona në rang vendi ose 25.4% (Ministria e drejtësisë, 2013; f. 55). Gjykata e Tiranës është po ashtu gjykata më përfaqësuese (K.L.D. 2007; 2011) nga pikëpamja e origjinës krahinore, formimit akademik dhe kulturor të trupës gjyqësore (elementë të cilët kanë një peshë në subjektivizmin gjyqësor gjatë procesit të individualizimit të dënimit). Kampioni i vendimeve të marra ka një shkallë të lartë përfaqësimi dhe për disa vepra penale me një frekuencë jo shumë të lartë ka një mbulim 100% të popullatës së tyre. Në këtë studim janë analizuar 400 vendime gjyqësore të kësaj gjykate, përkatësisht 200 krime dhe 200 kundërvajtje dhe përzgjedhja e tyre (për ato vepra penale për të cilat kampioni është më i vogël se popullata) është bërë tërësisht në mënyrë rastësore sipas renditjes që ato kanë në faqen zyrtare në web të Gjykatës së Tiranës.

Dënimi me gjobë sipas Kodit Penal shqiptar

Në pjesën e përgjithshme të kodit të ri penal shqiptar të vitit 1995, në kreun V të tij janë parashikuar tërësia e llojeve të dënimeve, i njohur në terminologjinë juridike si sistemi i dënimeve. Gjithsej për sistemin e dënimeve janë parashikuar 17 nene duke filluar nga neni 29 deri në nenin 46. Nga pikëpamja formalo strukturore, në kodin e ri penal janë ruajtur po ato kritere që kanë qenë në themel të sistemit të dënimeve në kodin penal të mëparshëm, pra ndarja në dy grupime të mëdha klasike, në atë të dënimeve kryesore dhe të dënimeve plotësuese (Elezi, Kaçupi, & Haxhia, 2013, fq. 223). Dënimet kryesore nga ana e tyre ndahen për krime dhe për kundërvajtje penale. Paragrafi i parë i nenit 29 të K. Penal parashikon dënimet kryesore për krimet, ndërsa në paragrafin e dytë parashikohen dënimet kryesore për kundërvajtjet penale. Sipas nenit 29 të kodit penal, dënimi me gjobë dhe ai me burgim janë dy dënimet kryesore të parashikuara si për krimet ashtu edhe për kundërvajtjet penale.

Me ligjin nr. 9086, datë 19.6.2003, në nenin 29 të K. Penal Kuvendi shtoi paragrafin e tretë, duke parashikuar se dënimi me burgim dhe gjobë mund të caktohen edhe bashkërisht, kur parashikohet në dispozitat përkatëse të këtij Kodi. Ky ishte një përjashtim nga rregulli tradicional dhe që karakterizonte vetë dënimet kryesore, pra caktimi vetëm i një dënimi kryesor për një vepër penale të kryer (Muçi, 2012, p. 270). Pas shtimit të këtij paragrafi, këto ndryshime parimore u reflektuan edhe në pjesën e posaçme të K. Penal, ku në një numër dispozitash penale dënimi me gjobë u parashikua të jepej nga gjykata krahas dënimit burgim. Pas disa ndryshimeve ligjore, në vitin 2012 numri i dispozitave penale të pjesës së posaçme që i parashikonin njëkohësisht të dy llojet e dënimeve kryesore arriti në 49 nene (konkretisht në nenet 83/a, 83/b, 109, 109/b, 110/a, 114/b, 117, 124/a, 124/b, 128/b, 135, 143/b, 164/a, 164/b, 186, 189, 190, 191, 197/a, 206/a, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 244, 244/a, 245, 245/1, 248, 248/a, 259, 259/a, 260, 287, 287/a, 287/b, 298, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 326, 326/a dhe 331 të K. Penal).

Pas kërkesës së Gjykatës së Apelit Vlorë për kontroll incidental të paragrafit të tretë të nenit 29 i K. Penal, Gjykata Kushtetuese me Vendimin Nr. 47, datë 26.07.2012 e ka pranuar këtë kërkesë, duke e shfuqizuar këtë dispozitë si në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, të sanksionuar nga neni 17 i Kushtetutës së Republikës. Në arsyetimin e saj Gjykata Kushtetuese shprehet se parashikimi a priori njëkohësisht i dy dënimeve kryesore edhe për vepra penale të tilla si falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve apo falsifikimi i akteve të gjendjes civile, nuk është në proporcion me gjendjen që i ka diktuar (lufta kundër krimit të organizuar) si dhe bie ndesh me parimin e individualizimit të dënimit e si rrjedhojë me parimin e dhënies së drejtësisë nga ana e gjykatës, pasi i heq kësaj të fundit mundësinë e përcaktimit, rast pas rasti, të dënimit penal sipas rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim.

Shfuqizimi nga Gjykata Kushtetuese i paragrafit të tretë të nenit 29 dhe të dënimit me gjobë në nenet 190 dhe 191 të pjesës së posaçme të K. Penal, u pasua me shfuqizim në nenet 83/a, 83/b, 109, 109/b, 110/a, 124/a, 128/b, 135, 143/b, 164/a, 164/b, 186, 189, 197/a, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 230/d, 244, 244/a, 245, 245/1, 248, 248/a, 259, 259/a, 260, 287, 287/a, 287/b, 298, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 326, 326/a dhe 331, të pjesës që parashikon si dënim kryesor edhe dënimin me gjobë, krahas dënimit me burgim.

Dispozita kryesore e K. Penal e cila detajon dënimin me gjobë dhe mënyrën e ekzekutimit të tij është neni 34 i tij. Kjo është një dispozitë e gjatë përshkruese, e cila ka pësuar ndryshime të shumta që nga viti 1995 dhe aktualisht është e përbërë nga 13 paragrafë. Dënimi me gjobë konsiston në pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit që aktualisht për kryerjen e një krimi varijon nga 100 mijë gjer në 10 milionë lekë ndërsa për kryerjen e një kundërvajtje penale, nga 50 mijë gjer në 3 milionë lekë. Në reflektim të vendimit nr. 47, datë 26.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese, caktimi i dënimit me gjobë krahas dënimit me burgim u kufizua edhe për rastet e kryerjes së krimeve për motive fitimi të pasurive. Sipas formulimit që paragrafi i

pestë i nenit 34 mori pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013 për rastet e kryerjes së krimeve për motive fitimi të pasurive ose të sigurimit të çdo lloj përfitimi tjetër material, gjykata vendos sipas nenit 36 të këtij Kodi, konfiskimin e mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale dhe vetëm në mungesë të tyre, vendos dënim me gjobë në masën nga 100 mijë deri në 5 milion lekë.

Një ndryshim po ashtu interesant i kësaj dispozite është sanksionimi i detyrimit të Gjykatës që të hetojë rreth aftësisë paguese të personit përpara se të caktojë dënimin me gjobë. Aftësia paguese sipas këtij rregullimi përcaktohet nga gjendja personale dhe pasurore e personit, si dhe nga rrethana të tjera që lidhen me to. Megjithëse ky paragraf vlerësohet si inovativ dhe i arsyeshëm nga aspekti i dhënies së një vendimi të bazuar gjyqësor, ai nxjerr në pah disa probleme procedurale që kanë të bëjnë me pozicionin pasiv të gjykatës gjatë shqyrtimit gjyqësor, me cenimin e paanësisë së saj në rast të kalimit të saj të përhershëm në një rol aktiv dhe së fundmi në shtyrjen e gjyqeve penale për të hetuar rrethana të tilla.

Një problem i madh praktik i implementimit të dënimit me gjobë dhe prej saj i humbjes së efektit ndëshkues, parandalues dhe edukues të këtij lloj dënimi, ka qenë ekzekutimi i tij. Përveç elementëve objektivë siç është pamundësia paguese e të dënuarit, kjo inefficencë është nxitur edhe nga hapësirat ligjore, të metat e shërbimit përmbartimor dhe një mungesë zhdërvjelltësie në ndjekjen në një kohë të shkurtër të këtyre procedurave nga prokuroria dhe gjykata. Një rol tejet negativ në kulturën e mosëkzekutimit të gjobave penale ka luajtur edhe shpeshhtësia e nxjerrjes së ligjeve amnistuese, të cilat kanë falur pjesën më të madhe të gjobave të caktuara nga gjykatat. Në një hapësirë prej 16 muajsh Kuvendi ka miratuar dy ligje për amnisti penale (Ligji nr. 107/2012 dhe ligji nr. 22/2014).

Pjesë e ngërçit ligjor në ekzekutimin e gjobave penale ka qenë dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 01.06.2011, i cili ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën, paragrafin 8 të nenit 34 të Kodit Penal, i cili parashikonte zëvendësimin e gjobës me burgim, duke llogaritur 5 mijë lekë për një ditë burgim, në rastin kur gjoba e caktuar nga gjykata nuk paguhej në afatin e caktuar. Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese arsyeton se konvertimi i dënimit me gjobë në dënimin me burgim është në përputhje me funksionin riedukativ të dënimit, në rastin kur i dënuari me vullnetin e tij të lirë refuzon t'i bindet vendimit gjyqësor që e detyron të paguajë gjobën. Në të kundërt, kur personi është në pamundësi objektive për të shlyer gjobën nisur nga kushtet ekonomike të të dënuarit (pra nuk varet nga ana subjektive e autorit), konvertimi i dënimit me gjobë në burgim, do të shkaktonte një trajtim të diferencuar të shtetasve vetëm në varësi të gjendjes ekonomike, duke sjellë si pasojë cenimin e parimit të barazisë para ligjit, të sanksionuar nga neni 18 i Kushtetutës.

Pas këtij vendimi me ligjin nr. 23/2012 datë 01.03.2012 u riformulua edhe ky paragraf duke parashikuar dy faza të ndjekjes së ekzekutimit të dënimit me gjobë. Sipas pikës 9 të këtij neni kur i dënuari nuk mund të paguajë gjobën në afat pa fajin e tij dhe nëse kriteret, mbi të cilat është caktuar gjoba, kanë ndryshuar pas dhënies së vendimit dhe nuk e justifikojnë haptazi pagimin e gjobës, atëherë i dënuari mund të kërkojë:

shtyrje të afatit të pagesës së gjobës gjer në gjashtë muaj;
kryerjen e një pune me interes publik.

Nisur nga mënyra se si është formuluar kjo dispozitë dhe nisur nga arsyet që e kanë shtyrë legjislatorin në këtë riformulim, duket se Gjykata është e detyruar që të vendosë sipas njëres prej alternativave të kërkuara nga vetë i dënuari. Ky rregullim parashikon se vetëm në fazën e dytë, pra nëse gjoba nuk paguhet edhe pas shtyrjes së afatit ose nëse i dënuari nuk e kryen punën në interes publik, atëherë gjykata vendos zëvendësimin e gjobës me burgim. Ky parashikim i ri e ka zgjidhur në një masë të madhe çështjen e mos burgosjes së shtetasve për shkak të paaftësisë së tyre paguese, megjithëse përsëri në disa raste më të pakta mund të ngrihen përsëri pretendime për antikushtetueshmëri të kësaj norme.

Vështrim i shkurtër krahasues i dënimit me gjobë sipas disa legjislacioneve penale europiane

Dënimi me gjobë është një nga dënimet më të rëndësishme të gjitha legjislacioneve penale të vendeve të zhvilluara. Në fillim të viteve '90 në vendet e Europës perëndimore dënimet me gjobë zinin nga 35-85 % të të gjitha dënimeve të dhëna nga gjykatat (Frase, 2001, f. 263). Shkalla e aplikimit të dënimit me gjobë ndikohet më pak nga fakti nëse një vend ka adaptuar sistemin e gjobave ditore (day fines) apo gjobat e përcaktuara (fixed summary fines) sesa nga fakti se sa shumë alternativa të tjera të dënimit me burgim zbaton ai sistem dhe cila është shkalla e aplikimit të këtyre alternativave.

Sistemi i dënimit të gjobave ditore është implementuar për herë të parë në vitin 1921 në Finlandë dhe më pas është shtrirë në shumicën e vendeve europiane duke përfshirë Danimarkën, Suedinë, Gjermaninë, Austrinë, Francën, Hungarinë, Poloninë, Portugalinë, Spanjën, Zvicrën (Grebing, 1982, f. 32) etj. Megjithëse sistemi i gjobave ditore aktualisht është implementuar nga shumica e vendeve europiane, gjithsesi vendi me suksesin më të madh në aplikimin e tyre është Gjermania, e cila që nga reforma e parë ligjore penale e vitit 1969, ka patur më shumë se 80 % të të dënuarve me gjobë (Heinz, 2006). Në vitin 2004, nga 670.279 të dënuar të rritur, 540.209 (ose 80.6 %) janë dënuar vetëm me gjobë.

Gjermania implementoi dy reforma të mëdha penale në vitin 1969 dhe 1975. Reforma e parë penale e miratuar në vitin 1969, rivendosi gjobën si sanksion penal dhe e bëri atë dënimin kryesor për krime që dënohen deri në 6 muaj burgim apo më pak (Friedman, 1983, f. 281). Ky rregullim u bë pasi shumë studime të kohës kanë treguar se dënimet me burgim të shkurtër bëjnë fare pak për të përmirësuar të pandehurit dhe se të pandehurit me rrezikshmëri të pakët të cilët dërgohen në burg për

një kohë të shkurtër, bëhen më të rrezikshëm nga vetë sistemi dhe dalin prej tij më të dhunshëm sesa ç'ishin kur u burgosën. Reforma e dytë e miratuar në vitin 1975 ndryshoi në mënyrë drastike llojin e gjobës duke kaluar në sistemin Skandinav të “gjobës ditore” e cila varijon në bazë të të ardhurave të të pandehurit. Sistemi gjerman bazohet në “të ardhurat neto ditore” ose në atë që i kushton një njeriu të lirë (Junger-Tas, 1994, f. 23).

Kodi penal i Finlandës në kapitullin e dytë, seksioni i dënimeve, parashikon gjobat ditore si një sanksion penal (i ndryshuar së fundmi me ligjin 550/1999). Numri minimal i njësive të gjobave ditore është një dhe maksimumi është 120. Shuma e një gjobë ditore llogaritet si 1/60 e të ardhurave mujore neto e të dënuarit. Gjykata verifikon të dhënat e tatimeve për të dënuarin për të përcaktuar të ardhurat e tij. Nëse gjoba nuk paguhet, dy gjoba ditore konvertohen në një ditë burgim.

Suedia adaptoi gjobat ditore në 1931 (Thornstedt, 1975, f. 307). Suedia aplikon “ekonominë strikte” si formë të gjobave ditore. Numri i njësive të gjobave ditore rritet me rrezikshmërinë e veprës, por nuk përshkallëzohet nëse autori ka kryer disa herë të njëjtën veprë. Megjithëse e ngjashme me vendet e tjera, Suedia ka një specifikë pasi mbi 75% e gjobave në Suedi vendosen nga prokurorët me marrëveshje të të akuzuarit (Thornstedt, 1975, f. 308). Në këtë vend dënohen me gjobë çdo vit mesatarisht rreth 70,000 nga 110,000 të dënuar. Gjykatat, prokuroria dhe policia kanë akses të palimituar në të dhënat e njohura nga autoritetet e taksave, megjithëse një informacion i tillë në praktikë rrallë herë përdoret (Albrecht, 1987, f. 8). Ekzekutimi i gjobave bëhet në mënyrë rutine nga policia si një proces mbledhje borxhesh dhe refuzimi për ti paguar çon në konfiskim të makinës dhe mobiljeve.

Në Danimarkë gjobat ditore u parashikuan në vitin 1939 (Thornstedt, 1975, f. 307) dhe variojnë nga një në 60 njësi. Ato mund të caktohen si dënim i vetëm apo të shoqëroren edhe me sanksione të tjera (si burgim, punë në shërbim publik etj.). Mos shlyerja e gjobës çon në konvertimin e saj në paraburgim sipas një raporti të caktuar. Në Danimarkë edhe policia dhe prokuroria mund të caktojnë gjoba, por ato janë gjoba fikse dhe të sheshta. Në ndryshim nga Suedia, në Danimarkë gjykatat mund të përshkallëzojnë dënimin në rastet e përsëritjes së krimit.

Mbretëria e Bashkuar i ka përdorur shkurtimisht “gjobat me njësi” të bazuara në të ardhurat e disponueshme javore. Projekte pilote u vendosën në katër gjykata magistratësh dhe u vlerësuan nga Home Office Research and Planning Unit. Megjithëse gjetjet ishin pozitive dhe Criminal Justice Act i 1991 vendosi një sistem kombëtar të gjobave me njësi që të hynin në fuqi në tetor 1992, ky sistem u braktis 7 muaj më vonë. Arsyet e vërteta për këtë ndryshim janë të paqarta, por shumë autorë fajësojnë mbulimin e keq të mediave dhe keq zbatimin e gjobave si një justifikim për ta braktisur (Tonry and Lynch, 1995, f. 130-131).

Dënimi me gjobë në Itali (e njohur si pene pecuniarie) ndahet nga neni 17 i Kodit penal në “multa” që është një gjobë për krimet dhe “ammenda” për kundërvajtjet (Miedico, 2008, f. 20). Gjoba për krimet variojnë nga 50-50.000 euro, ndërsa për kundërvajtjet nga 20-20.000 euro (Kodi penal italian 2014). Megjithëse Italia nuk ka përqaftuar sistemin e gjobave ditore, në nenin 133-*bis*. parashikohet se në përcaktimin e masës së gjobës, përveç kriterëve të përgjithshme të caktimit të dënimit gjyqtari duhet të mbajë parasysh dhe kushtet ekonomike të të dënuarit. Sipas këtij neni nëse gjyqtari vlerëson se masa e gjobës që parashikon ligji është e butë, mund ta trefishojë atë dhe nëse vlerëson se është shumë e rëndë mund ta ulë deri në 1/3 e saj.

Megjithëse siç u pa Italia ka një sistem të sheshtë të caktimit të gjobave, pesha që ka zënë ky lloj dënimi në praktikën gjyqësore ka qenë e konsiderueshme. Nga viti 1996-2004 dënimi me gjobë ka zënë rreth 50 % të gjithë totalit të dënimeve për krime dhe për kundërvajtje dhe rreth 40% të dënimeve për krime (Miedico, 2008, f. 20). Megjithatë aktualisht ky lloj dënimi konsiderohet aktualisht në një impas praktik (Goisis, 2012) për shkak të krizës ekonomike, problemeve të kriterëve të caktimit të këtij dënimi dhe ekzekutimit të tij (Polinsky & Shavell, 1998, f. 78), ku në vitin 2011 përqindja e dënimeve me gjobë ka rënë në 28.8% (ISTAT, 2011, f. 171).

Kodi i penal Francez parashikon një sistem të gjobave ditore për krime dhe për kundërvajtje. Po ashtu ky kod parashikon në nenin 131-5 konvertimin e dënimit me burg në gjobë ditore. Po ashtu nenin 131-13 siguron një aplikim shumë të gjerë të gjobave për krime të lehta të ndara në 5 shkallë.

Kodi penal maqedonas pas ndryshimeve të vitit 2004 e parashikon sistemin e gjobave ditore në nenin 38, duke parashikuar si minimum 5 gjoba ditore dhe si maksimum 360 të tilla dhe ku minimumi i një gjobe ditore mund të jetë 1 euro dhe maksimumi 5.000 euro. Sipas këtij neni vlera konkrete e një gjobe ditore përcaktohet nga niveli i të ardhurave ditore neto të të pandehurit. Po ashtu vende të tjera të Ballkanit si Sllovenia dhe Kroacia kanë vite që e kanë implementuar me sukses (Kambovski, 2007, f. 487) sistemin e gjobave ditore.

Edhe Kodi penal grek në nenin 82 parashikon një hapësirë të aplikimit të dënimit me gjobë për vepra penale të lehta të cilat janë dënuar deri në dy vite burgim ose për pjesë të mbetura të një dënimi më të rëndë. Konvertimi i dënimit me burg në gjobë edhe sipas këtij kodi është i përshkallëzuar sipas një sistemi përlllogaritjeje ditor nga 4.4-59 euro dhe në raste pamundësie pagese gjykata mund ta ulë përsëri masën deri në 1/3 e saj.

Pesha që i kanë rezervuar dënimit me gjobë legjislacionet përkatëse penale të vendeve europiane dhe gjykatat e këtyre vendeve duket se është në përpjesëtim të zhdrejtë me shkallën e burgosjes. Vende si Gjermania, Finlanda apo Suedia me një aplikim të gjerë të gjobës si dënim penal kanë norma të ulëta të burgosurve, ndërsa vende me një aplikim inferior të saj si Anglia, Estonia apo Shqipëria kanë një nivel të lartë të burgosurve.

Caktimi i dënimit me gjobë nga Gjykatat shqiptare

Në këtë seksion do të përpiqemi që përmes metodave sasiore të paraqesim një panoramë të dënimit me gjobë sipas praktikës gjyqësore të vendit tonë. Gjatë vitit 2012 nga totali i të dënuarve për krime dhe kundërvajtje penale vetëm 3114 apo 35.8% janë dënuar me gjobë (Ministria e Drejtësisë, 2013, f. 62), ndërsa në vitin 2013 ku numër është ulur në 2357 të dënuar apo

27.5 % (Ministria e Drejtësisë, 2014, f. 63). Raporti i të dënuarve me gjobë për kundërvajtjet është shumë më i lartë se për krimet. Kështu në vitin 2012 rreth 77.2 % e kundërvajtësve janë dënuar me gjobë, ndërkohë që për krimet janë dënuar me gjobë vetëm 21.5 %. Në vitin 2013 të dënuarit me gjobë për kundërvajtje zënë 60 % ndërsa për krime vetëm 14.8 %. Nisur nga ashpërsimi i politikës penale për disa vepra penale me një frekuencë të lartë për të cilat dënimi me gjobë është hequr (si vjedhja e energjisë elektrike, drejtimi i mjeteve në mënyrë të parregullt, apo falsifikimet) dhe nga një frymë e dukshme pro burgimit, në vitin 2014 dhe më tej në vitin 2015 pesha e dënimit me gjobë do të jetë akoma më e ulët. Megjithëse akoma për këtë periudhë nuk ka të dhëna statistikore kombëtare të Ministrisë së Drejtësisë, nga analiza vjetore e vitit 2014 e gjykatës së Tiranës (2015; f. 23) vërehet se dënimi me gjobë për këtë vit zë vetëm 13.4% të totalit, ndërsa nga ajo e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (2015; f. 21) është 17.7 %.

Për një analizë më të thelluar të jurisprudencës gjyqësore në lidhje me aplikimin e dënimit me gjobë kemi kryer një vëzhgim të drejtpërdrejtë të praktikës gjyqësore. Në kryerjen e këtij vëzhgimi jemi fokusuar vetëm në disa vepra penale të cilat në vitet e fundit kanë patur një frekuencë shumë të lartë gjyqësore. Kështu nga 334 nene që ka aktualisht në fuqi pjesa e posaçme e kodit penal, në vitin 2012 vetëm sipas 15 neneve (më saktë paragrafëve) janë dënuar 5096 persona apo 58.7 % e totalit të dënuarve dhe në vitin 2013 vetëm sipas 20 neneve (paragrafëve) të K. Penal janë dënuar 4477 persona, apo 55.7 % e totalit.

Nga analizimi llojit dhe i masave të dënimit në kampionin prej 400 vendimesh gjyqësore rezultoi se ato paraqiten si në tabelën 1 më poshtë:

TABELA 1. LLOJI DHE MASAT E DËNIMIT TË CAKTUARA NGA GJYKATA TIRANË.

200 Kundërvajtje					200 Krime				
136 të dënuar me gjobë ose 68%					40 të dënuar me gjobë ose 20 %				
50-75 mijë lekë	76-100 mijë lekë	101-150 mijë lekë	151-300 mijë lekë	Mbi 300 mijë lekë	101-150 mijë lekë	151-200 mijë lekë	201-300 mijë lekë	301-500 mijë lekë	Mbi 500 mijë lekë
38 ose 30 %	26 ose 19.1 %	44 ose 32.3 %	26 ose 19.1 %	2 ose 1.5 %	21 ose 52.5 %	5 ose 12.5 %	8 ose 20 %	4 ose 10 %	2 ose 1%

Siç vërehet, nga kampioni i 200 vendimeve të dënimit për kundërvajtje penale 68 % e tyre janë dënuar me gjobë. Nga ana tjetër nga kampioni i vendimeve të dënimit për krime rezultoi se vetëm 20 % e të pandehurve janë dënuar me gjobë, ndërsa pjesa tjetër janë dënuar me burgim (brenda të cilëve përfshihet dhe dënimet alternative).

Përveç të dhënave të paraqitura në këtë tabelë, vlen të përmenden edhe disa gjetje domethënëse që kanë të bëjnë me tipologjinë e veprave të kampionuara. Kështu për kundërvajtjet ndeshet një aplikim i dënimit me gjobë në 98 % të rasteve për nenin 197 të K. Penal, 68% për nenin 89 dhe vetëm 44 % për nenin 84 të K. Penal. Nga ana tjetër për kampionin e krimeve rezultoi se dënimi me gjobë është aplikuar vetëm 10 % për “Vjedhje” (nenin 134/1 të K. Penal), ndërkohë që për “Mashttrim” (neni 143/1), “Mashttrim në sigurime” (neni 145), apo “Shkatërrimi i pronës” (neni 150) është aplikuar në mbi 30 %. Shpjegimi logjik i një diferencimi të tillë (për vepra të ngjashme me objekt grupor pasurisë) vështirësohet edhe më tej po të mbahet në konsideratë fakti se nga kampioni i vendimeve rezulton se vlera mesatare e pasurisë së humbur nga vjedhja është më e vogël se e pasurisë së humbur/dëmtuar nga tre veprat e tjera. Me gjasë, i vetmi justifikim për këtë diferencë është përhapja disa herë më e lartë e vjedhjes se e veprave të tjera kundër pasurisë.

Më tej nga ky vëzhgim rezultoi se 39 % të të dënuarve me gjobë për kundërvajtje janë dënuar nga 50.000 deri në 100.000 lekë, ndërsa 65 % të të dënuarve për krime janë dënuar nga 100.000-200.000 lekë. Megjithëse në shumicën e rasteve të analizuara në kampion, masa e dënimit me gjobë është shumë më afër minimumit sesa maksimumit të parashikuar nga neni 34 i K. Penal (maksimumi për kundërvajtje është 3 milion lekë ndërsa për kundërvajtje 10 milionë lekë), në krahasim në nivelin ekonomik mesatar të shoqërisë shqiptare, në mjaft raste është i lartë. Nga të dhënat e INSTAT, në Shqipëri (2014) paga mesatare mujore e një të punësuarit në administratën publike në vitin 2013 ka qenë 52 000 lekë ose 371 euro, ndërkohë që për familjet në nevojë (të cilët janë një kontingjent i shumë veprave penale, si vjedhja, vjedhja e energjisë elektrike etj.) pagesa maksimale e ndihmës ekonomike për një familje ka është maksimumi 7000 lekë në muaj (V.K.M. nr. 787, 2005).

Nga ana tjetër në Shqipëri nuk është bërë ndonjë studim i detajuar në lidhje me kostot ditore të burgimit të një personi, mirëpo sipas një vlerësimi të OSCE kostoja mujore e një të burgosuri në Shqipëri është 439 euro në muaj apo 5300 euro në vit (Raunig, 2014). Këto kosto marrin parasysh vetëm shpenzimet që kanë në vit institucionet penitensiare në raport me numrin e të burgosurve, por nuk marrin në konsideratë kosto të tjera shtesë si shpenzimet qeveritare apo donacionet për ngritjen e burgjeve të reja apo riparimin dhe përmirësimin e atyre ekzistues, shpenzimet që kryejnë familjet për të vizituar dhe kujdesur për të afërmit e tyre të burgosur, mosmarrja e të ardhurave që i burgosuri merrte kur punonte jashtë burgut, rënia e aftësive profesionale të të burgosurve etj. Nga ana tjetër megjithëse shuma prej 5300 euro në vit është shumë e vogël në krahasim me kostot e vendeve të zhvilluara perëndimore, përsëri për ekonominë e brishtë shqiptare këto janë kosto të konsiderueshme po të mbahet parasysh se GDP për frymë në vitin 2013 ishte vetëm 4,652 \$ (World Bank, 2014), apo rreth 3520 euro në vit.

Është e paarsyeshme që minimumi i dënimit me gjobë sipas legjislacionit shqiptar të jetë (sa mesatarja e pagës bruto mujore të një zyrtari) dhe në vlerë absolute disa herë më i lartë se i Greqisë, Italisë, Finlandës, Francës apo Gjermanisë për të cilët siç u përmend më lart varijon nga 1 euro deri në maksimumin e të ardhurave ditore të të pandehurit. Si ilustrim të nivelit

të lartë të minimumit të gjobës penale në vendin tonë mund të përmendim se në vitin 2003 në Itali 70 % të të dënuarve me gjobë për krime kanë marrë një gjobë nën 1000 euro ndërsa 82 % nën këtë shumë për kundërvajtje penale (ISTAT, 2006. f. 45).

Ndryshimet e bëra në kodin penal me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001 të cilat kanë dhjetëfishuar masat e dënimit me gjobë (si për krime ashtu edhe për kundërvajtje), kanë qenë të pastuduara dhe kanë ndikuar negativisht në frenimin e aplikimit të këtij dënimi. Dënimi me gjobë ashtu si edhe dënimi me burgim kanë për qëllim edukimin e fajtorëve dhe të komunitetit dhe jo rrënimin e tyre ekonomik. Këto masa të cilat janë në fuqi kanë një diferencë të madhe jo vetëm me masat e dënimit me gjobë që parashikohen në Kodin penal ushtarak², por vijnë në kontradiktë logjike edhe me minimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga neni 32 i K. Penal dhe konvertimin e tij në gjobë³. Po ashtu masa e minimumit të gjobës ka një hendek logjik akoma më të dukshëm edhe me parashikimet e nenit 63 të K. Penal ku gjykata mund të pezullojë ekzekutimin e vendimit me burgim deri në një vit burgim, duke detyruar kryerjen e një pune në interes publik për një kohë nga dyzet deri në dyqind e dyzet orë (pra nga 5 deri në 30 ditë pune). Këto diferenca të dukshme dhe mungesa e një diskrecioni më të gjerë të gjykatës për të përcaktuar masën e gjobës nisur nga mundësitë reale ekonomike të të pandehurit (sidomos për persona që kanë shumë më pak se 10.000 lekë të ardhura për frymë në muaj) nxisin nevojën e një rimendimi të marzheve të dënimit me gjobë dhe të mënyrës së llogaritjes së saj.

Adaptimi i sistemit të gjobave ditore, megjithëse fillimisht mund të ndeshë në hezitime për shkak të një pabarazie formale mes të pandehurve, do të nxiste barazinë substanciale në trajtimin e të pandehurve dhe nga ana tjetër përmes një aplikimi më të gjerë të këtij lloji dënimi, do të shërbente jo vetëm në uljen e mbipopullimit të burgjeve, uljen e kostove të sistemit të drejtësisë penale, por edhe në riedukimin dhe përmirësimin më të suksesshëm të personave të dënuar (sidomos ata me një rrezikshmëri të vogël shoqërore të cilët aktualisht vetëm për këtë shkak po dënohen panevojshëm me dënime të shkurtra me burgim). Në këtë drejtim ulja e minimumit të masës së dënimit me gjobë si dhe shtimi i neneve në pjesën e posaçme të K. Penal të cilat lejojnë konvertimin e dënimit me burgim në dënim me gjobë (siç është aktualisht vetëm neni 291 i K. Penal) do ta kthente dënimin me gjobë në dënimin dominues penal në vendin tonë.

Studimet e zhvilluara mbi eksperiencën gjermane kanë provuar se personat e dënuar me gjobë kanë një shkallë rikriminalizimi (përsëritje të një veprë tjetër penale pas dënimit të dhënë) prej 28%, ato të dënuar me burg me kusht 41% dhe ata me burg 52% (Jehle et al, 2010). Këto studime mbështesin qëndrimin se burgimi është një mënyrë e kushtueshme për të bërë keqbërësit njerëz akoma më të këqij (Soring, 2004. f. 54).

Konkluzione/ Rekomandime

Në legjisllacionin tonë penal dënimi me gjobë paraqitet inferior në raport me dënimin me burgim dhe në tre vitet e fundit aplikimi i tij ka ardhur në rënie të vazhdueshme. Kjo ka ndodhur për arsye të ndryshimeve ligjore të cilat kanë ngushtuar hapësirat e caktimit të këtij lloji dënimi dhe për shkak të një fryme politike dhe mediatike pro burgimit. Masat e dënimit me gjobë të parashikuara në K. Penal janë po ashtu të larta dhe në dispropocion me të ardhurat e një pjese të personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale.

Nga shqyrtimi krahasues vërehet se në shumë vende të Europës Perëndimore dënimi me gjobë përdoret gjerësisht krahas alternativave të tjera të dënimit me burgim si zgjidhje më e drejtë dhe më e zgjuar për të luftuar kriminalitetin dhe ulur kostot ekonomike dhe njerëzore të burgimit. Shumica e këtyre vendeve kanë adaptuar sistemin e gjobave ditore, e cila ofron një barazi më substanciale të dënimeve për persona me mundësi të ndryshme ekonomike, duke rritur kështu shanset e një procesi më të suksesshëm edukues dhe rehabilitues të të dënuarve. Gjermania është vendi model i suksesit të aplikimit të dënimit me gjobë, ku në mënyrë konsistente dhe për një kohë të gjatë ka treguar me shifra se është mënyra më e mirë për kontrollin e kriminalitetit dhe njëkohësisht mbajtjen në nivel të ulët të normës së të burgosurve. Për fat të mirë, studimi dhe kopjimi i eksperiencave më të mira ligjore të vendeve më të zhvilluara nuk përbën plagjiaturë, madje është e inkurajuar nga vendet që i aplikojnë.

Bibliografia

- Albrecht, H.-J. (2012), Sanction policies and alternative measures to incarceration: European experiences with intermediate and alternative criminal penalties, United Nations Asia and Far East Institute for the Prevention of Crime and the Treatment of Offenders.
- Elezi, I., Kaçupi, S., & Haxhia, M. (2013). Komentari i kodit penal, pjesa e përgjithshme, Botimet Kumi, Tiranë.
- Frase, S. R. (2001). Comparative Perspectives on Sentencing Policy and Research. In: M. Tonry and R.S. Frase, eds. Sentencing and Sanctions in Western Countries. New York: Oxford University Press, pp. 259–292.
- Friedman, G.M. (1983). West German Day fine System — A Possibility for the United States? University of Chicago Law Review 281-304.

Për personat që kryejnë krim, gjoba jepej nga 10 mijë deri në 2 milionë lekë, ndërsa për personat që kryenin kundërvajtje gjoba variante nga 5 mijë deri në 200 000 lekë.

Sipas nenit 9 të K. P. Ushtarak për personat që kryejnë krim, gjoba jepet nga 10 mijë deri në 2 milionë lekë, ndërsa për personat që kryejnë kundërvajtje gjoba jepet nga 5 mijë deri në 2 qind mijë lekë.

Sipas nenit 32 dënimi me burgim fillon si për krimet dhe për kundërvajtjet me pesë ditë burgim të cilat sipas nenit 57 të K. Penal konvertohen në 25.000 lekë gjobë.

- Grebing, G. (1982). *The Fine in Comparative Law: A Survey of 21 Countries* (Institute of Criminology, Occasional Papers No 9. Gjykata Kushtetuese. (2011). Vendimi nr.19, datë 01.06.2011 i Gjykatës Kushtetuese. Tiranë.
- Gjykata Kushtetuese. (2012). Vendimi nr. 47, datë 26.07.2012 i Gjykatës Kushtetuese. Tiranë.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (2015). *Analiza vjetore e vitit 2014 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër (2015). *Analiza vjetore e vitit 2014 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*.
- Halili, R. (2014). *Penalogjia, botimi i shtatë*, Prishtinë.
- Heinz, W. (2006). *Penal Sanctions and Sanctioning Practice in the Federal Republic of Germany 1882 – 2004*. E aksesueshme në: http://www.uni-konstanz.de/rtf/kis/sanks04_eng.htm.
- INSTAT (2014). *Paga mesatare mujore në sektorin shtetëror dhe paga minimale zyrtare, 2000-2013*. E aksesueshme në: <http://www.instat.gov.al/al/themes/pagat-dhe-kosto-e-pun%C3%ABs.aspx>.
- ISTAT. (2006). *Statistiche giudiziarie penali. Anno 2004*, in *Annuario 2006*, Roma, 2006.
- ISTAT. (2011). *Annuario statistico italiano. Anno 2011*, Roma, 152 ss., Tabella 6.19, p. 171, Tabella 6-20, p. 172. I aksesueshëm në: www.istat.it.
- Jehle, J. M.; Albrecht, H. J.; Hohmann-Fricke, S.; Tetel, C. (2010). *Probation following criminal sanctions – A nationwide study of recidivism between 2004 – 2007*. Federal Ministry of Justice, 2010.
- Junger-Tas, J. (1994). *Alternatives to Prison Sentences Experiences and Developments*. Amsterdam and New York: Kugler Publications.
- Kambovski, V. (2007) *E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, përkthim në gjuhën shqipe, botimi i dytë*, Shkup. Kantorowicz, E. (2015). *The Secret of a Cheaper Sentencing System: Lessons from Europe*. Rotterdam Institute of Law and Economics (RILE) Working Paper Series. No. 2015/01. p 26.
- Këshilli i Lartë i Drejtësisë. (2007). Vendimi nr. 216/3, datë 28.09.2007 i K.L.D. Tiranë.
- Këshilli i Lartë i Drejtësisë. (2011). Vendimi nr. 281, datë 14.11.2011 i K.L.D. Tiranë.
- Miedico, M. (2008). *La pena Pecuniaria: Disciplina, prasi e prospettive di riforma*. Egea s.p.a Milano.
- Ministria e Drejtësisë (2013). *Vjetari statistikor 2012*. Tiranë.
- Ministria e Drejtësisë (2014). *Vjetari statistikor 2013*. Tiranë.
- Morris, N. & Tonry M. (1991). *Between Prison and probation. Intermediate punishments in a rational sentencing system*. Oxford University press, New York.
- Muçi, Sh. (2012). *E Drejta penale, Pjesa e përgjithshme (edicioni i tretë)* Tiranë: Guttenberg.
- Nikolli, A. (2015). *Historical and Comparative Analysis of Changes in the Albanian Penal Code. The Criminalization of Behaviours and Severity of Punishment*. Mediterranean Journal of Social Sciences. Vol 6 No 1 January 2015. Rome. f. 300-308.
- Goisis, L. (2012). *L'effettività (rectius ineffettività) della pena pecuniaria in Italia, oggi*. Milano. E aksesueshme në : http://www.penalecontemporaneo.it/tipologia/4/-/-/1835-1_effettivit_rectius_ineffettivit_della_pena_pecuniaria_in_italia_oggi/.
- Polinsky, A.M. & Shavell, S. (2000). *The fairness of sanctions: some implications for optimal enforcement policy*, American Law and economics review 2, 22-237.
- Raunig, F. (2014). *Reforma në burgje. Mbipopullimi problem kyç*. Agjensia Telegrafike Shqiptare, 2 Korrik 2014. Tiranë.
- Soring, J. (2004). *An expensive way to make bad people worse: an essay on prison reform from an insider's perspective* - New York - Lantern Books – 2004.
- Miethe, T. & Lu, H. (2005), *Punishment, a comparative historical perspective*, Cambridge University press, New York.
- Thornstedt, H. (1978). *The Day-Fine System in Sweden*. The Criminal Law Review.
- Tonry, M. & Lynch M. (1995). "Intermediate Sanctions." In M. Tonry (ed.), *Crime and Justice: A Review of Research*, vol. 20; Chicago: University of Chicago Press, pp. 99-144.
- World Bank. (2014). *GDP per capita*. E Aksesueshme: <http://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD>.

Legjislacion

- Kodi penal i Republikës së Shqipërisë. (1995). I miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, hyrë në fuqi me 01.06.1995, i azhurnuar në vitin 2015.
- Kodi penal ushtarak i Republikës së Shqipërisë.(1995). I miratuar me ligjin nr. Nr.8003, datë 28.9.1995, hyrë në fuqi me 15.11.1995, i azhurnuar në vitin 2009.
- Codice penale Italiano. (1930). I shpallur me dekretin e 19 Tetor 1930, hyrë në fuqi me 01.07.1931, i azhurnuar në vitin 2014. Criminal Code of Germany (Strafgesetzbuch, StGB), (1998). English translation provided by the Federal Ministry of Justice. The version promulgated on 13 November 1998,
- Federal Law Gazette [Bundesgesetzblatt] I p. 3322, last amended by Article 3 of the Law of 2 October 2009, Federal Law Gazette I p. 3214.
- The Criminal Code of Finland (2012). I miratuar me ligjin 39/1889. English translation. Amendments up to 927/2012 included.
- Penal Code of France. (2005). English translation. Enacted on 22 July 1992 and entered into force on 1 March 1994, updated version of 2005.
- Penal Code of Greece. (2013). English translation. Enacted with law 1492/1950 in 1950. Amendments up to the law 927/2012.
- Ligji „Për dhënie amnistie“ (2012), miratuar me ligjin nr. 107/2012, hyrë në fuqi me 28 nëntor 2012.
- Ligji „Për dhënie amnistie“ (2014), miratuar me ligjin nr. 22/2014, hyrë në fuqi me 10 Prill 2014.
- Ligji nr. 8733, datë 24.01.2001, për disa ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”. Ligji nr. 9086, datë 19.06.2003, për disa ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”. Ligji nr. 23/2012, datë 01.03.2012, për disa ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”. Ligji nr. 144/2013, datë 02.05.2013, për disa ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 787, datë 14.12.2005, „Për caktimin e kriterëve të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike“

GARANCITË KUSHTETUESE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË: ASPEKTE KRAHASUESE

PHD CAND. ANA DHAMO

Universiteti Europian I Tiranes

ABSTRAKT

Studimi i garancive kushtetuese është i një rëndësie thelbësore ne vendet e Amerikës Latine. Ne kartat kushtetuese të pjesës me te madhe te shteteve, deklaratat solemne të të drejtave kushtetuese dhe bekimi i tyre si te drejta të gjeneratës së parë dhe te fundit, kane një vlere formale që vetëm garancitë kushtetuese janë ne gjendje t'i transformojnë ato ne reale. Pra, te gjitha te drejtat e përmendura nga kartat kombëtare dhe ndërkombëtare, nëse nuk mbështeten nga garancitë kushtetuese me instrumente procesuale te nevojshëm për mbrojtjen e tyre, nuk janë gjë tjetër veçse dëshira politike te thjeshta. Nuk kanë asnjë baze ne realitet. Sistemi i drejtësisë kushtetuese në pjesën më të madhe të vendeve latino-amerikane parashikon rekurse dhe gjykime te habeas corpus, amparo dhe habeas data, për të gjithë individët te cilëve i është cenuar një e drejtë. Po kështu, njihet edhe e drejta e shtetasve te bëjnë rekurs të drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese kundër antikushtetueshmërisë totale apo parciale te ligjeve ose te akteve normative te cilat janë dukshëm në kundërshtim me kushtetutën. Mund të pohojmë se sistemi latino-amerikan i drejtësisë dhe garancive kushtetuese është zhvilluar dhe pasuruar qe nga vitet e para të pavarësisë te shteteve te reja. Garancitë Kushtetuese për mbrojtjen e te drejtave dhe lirive themelore te njeriut trajtohen gjerësisht edhe ne Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Në një vështrim krahasues mes vendit tone dhe realiteteve te Amerikës Latine, vërejmë qartë një ndryshim thelbësor ne aspektin e garancive. Ne rast gjendjesh të jashtëzakonshme, gjendje lufte apo fatkeqësie natyrore, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon ndërprerjen e disa prej te drejtave dhe lirive themelore te sanksionuara ne te. Ky aspekt, duke rikthyer ne kujtesën e të gjithë popullit shqiptar trazirat e vitit 1997, kërkon përkushtim nga ana e ligjvënësit kushtetues, me qëllim rishikimin e hollësishtëm te kapitullit te garancive kushtetuese për mbrojtjen universale te lirive dhe te drejtave te individit.

Fjalë kyç: *garanci kushtetuese, habeas corpus, habeas data, Kushtetuta e RSH.*

1. Hyrje

Studimi i garancive kushtetuese është i një rëndësie thelbësore në vendet e Amerikës Latine. Në kartat kushtetuese të pjesës më të madhe të shteteve, deklaratat solemne të të drejtave kushtetuese dhe bekimi i tyre si të drejta të gjeneratës së parë dhe të fundit, kanë një vlerë formale që vetëm garancitë kushtetuese janë në gjendje t'i transformojnë ato në reale. Pra, të gjitha të drejtat e përmendura nga kartat kombëtare dhe ndërkombëtare, nëse nuk mbështeten nga garancitë kushtetuese me instrumente procesuale të nevojshëm për mbrojtjen e tyre, nuk janë gjë tjetër veçse dëshira politike të thjeshta. Nuk kanë asnjë bazë në realitet.

Sistemi i drejtësisë kushtetuese në pjesën më të madhe të vendeve latino-amerikane (eksperiencat e Argjentinës, Brazilit, Kosta Rikës, Kolumbisë, Venezuelës, Perusë), parashikon rekurse dhe gjykime të *habeas corpus*, *amparo* dhe *habeas data*, për të gjithë individët të cilëve i është cenuar një e drejtë.

Po kështu, njihet edhe e drejta e shtetasve të bëjnë rekurs të drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese kundër antikushtetueshmërisë totale apo parciale të ligjeve ose të akteve normative të cilat janë dukshëm në kundërshtim me kushtetutën. Mund të pohojmë se sistemi latino-amerikan i drejtësisë dhe garancive kushtetuese është zhvilluar dhe pasuruar që nga vitet e para të pavarësisë të shteteve të reja, duke filluar nga krijimi i *habeas corpus*, *amparo* dhe aksionit publik të antikushtetueshmërisë. Sot ky sistem përfaqëson është një konsakrim kushtetues të disa garancive dhe të drejtave të tjera të rëndësishme. Mes tyre mund të përmendim mbrojtjen e të dhënave, të informacioneve dhe të intimitetit personal dhe familjar. *Habeas corpus* në Amerikën Latine e ka zanafillën nga modelet spanjolle të fueros. Aktualisht kjo garanci është e konsakruar në të gjitha kushtetutat e Shteteve latinoamerikane, si një institut për mbrojtjen e lirisë personale.

Garancitë Kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut trajtohen gjerësisht edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Në një vështrim krahasues mes vendit tonë dhe realiteteve të Amerikës Latine, vërejmë qartë një ndryshim thelbësor në aspektin e garancive. Në rast gjendjesh të jashtëzakonshme, gjendje lufte apo fatkeqësie natyrore, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon ndërprerjen e disa prej të drejtave dhe lirive themelore të sanksionuara në të.

2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi dhe rëndësia e këtij studimi është pikërisht evidentimi i problemit të ndërprerjes së garancive kushtetuese në Kushtetutën e RSH, dhe zgjidhja e këtij problemi duke marrë shkas nga Kushtetutat e reja të vendeve të Amerikës Latine të cilat kanë garantuar liritë dhe të drejtat individuale pa i kufizuar minimalisht ato.

3. Te drejtat, garancitë dhe detyrimet

Titulli i II. mbi garancitë dhe të drejtat është më i gjati i Kushtetutës së 1991, me 84 nene të ndara në pesë kapituj: të të drejtave themelore, të të drejtave sociale, ekonomike dhe kulturore, të të drejtave kolektive dhe të mjedisit, të mbrojtjes dhe aplikimit të drejtave e të detyrimeve. Shtetësia dhe të drejtat politike inkuadrohen në tituj të tjerë, i III dhe i IV në pjesëmarrjen demokratike dhe partitë politike.

Nga titulli mbi të drejtat duhet të rilevohen më tepër aspekte pozitive se sa negative. Mes të dytëve duhet përmendur retorika e disa prej këtyre neneve, si ajo mbi «zhdukjen e forcuar» (neni 12), i vështirë apo i pamundur për t'u kuptuar në një shtet që garanton të drejtën e jetës. Madje, neni 17, i cili ndalon skllavërinë, dhe tregtimin e qenieve njerëzore, nuk shpjegohet nëse konsiderojmë ekzistencën e neneve mbi barazinë dhe lirinë, me përjashtim të rastit nëse kujtojmë që Kolumbia, nga epoka e Bolivarit shfuqizoi skllavërinë. Një tjetër nen, 22, i cili shpall paqen si një e drejtë dhe detyrë që mund të kuptohet vetëm nëse kujtojmë faktin që vendi jeton, në më shumë së gjysmë shekulli, në një luftë të padeklaruar dhe si rrjedhojë ka nevojë për paqe. Me këtë qëllim mbase është e nevojshme të kujtohet se paqja është bija e drejtësisë dhe se emri i ri paqes është zhvillimi.

Një tjetër nen që nuk ka një shpjegim juridik por as i një politike ekonomike është neni 65, i cili shpreh tekstualisht se shteti do t'i ofrojë mbrojtje të posaçme prodhimit të ushqimeve, kur problemi, më tepër se për prodhimin ushqimor, është ai i zhvillimit të përgjithshëm dhe i reformave sociale dhe ekonomike, mes të cilave mbi të gjitha ajo bujqësore.

Mes aspekteve pozitive të këtij titulli meritojnë të kujtohen: e drejta - garanci e re e *habeas data* - s (neni 15), e nevojshme në epokën elektronike, të teknologjisë informatike dhe e bankave të të dhënave. Mbi bazën e këtij instituti, çdokush ka të drejtën të njohë, azhurnojë dhe ratifikojë informacionet që mbi personin janë mbledhur në bankat e të dhënave dhe në arkivat e enteve publike dhe private, me një rekurs juridiksional analog me atë në fuqi prej shume shekujve për mbrojtjen e lirisë personale, pikërisht *habeas corpus*.

Një tjetër e drejtë e re e Kushtetutës kolumbiane të vitit 1991 është *amparo* ose mbrojtja (neni 86), sipas të cilës çdo individ mund t'i kërkojë gjyqtareve, nëpërmjet një procedure preferenciale dhe të shpejte, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një të treti, mbrojtjen imediate të të drejtave të tij kushtetuese themelore, nëse janë shkelur ose nëse parashikohet një shkelje e tyre për veprimin apo mosveprimin e çdo autoriteti publik ose privat, ose nëse sjellja e këtyre të fundit cenon rendin dhe drejtpërdrejt interesin kolektiv ose respektin ndaj të cilëve kërkuesi gjendet i nënshtruar apo pa mbrojtje. Duhet shtuar fakti se *amparo* ose mbrojtja i korrespondon një garancie tradicionale dhe shekullore të së drejtës publike latino-amerikane dhe se sistemi kushtetues kolumbian në këtë rast është azhurnuar pozitivisht.

Një norme e re kushtetuese që lidhet me të drejtën e pronësisë dhe që, nëse përdoret në mënyrë efektive ose funksionale, shërben për të zgjidhur shume problematika të drejtësisë dhe të barazisë sociale ekzistuese në Kolumbi, si në zonat rurale ashtu edhe në ato urbane. Behet fjalë për nenin 58, sipas të cilit për arsye të nevojave publike ose të interesit social ligji mund të dekretojë shpronësimin pa asnjë lloj dëmshpërblimi. Gjithashtu, në rast të veçanta të vendosura nga ligjvënësi, shpronësimi mund të kryhet edhe me rruge administrative, domethënë në mungesë të një vendimi gjyqësor, pa prekur natyrisht të drejtën e një rekursi administrativ. Duke aplikuar këtë normë të re shteti kolumbian mund të çojë përpara mbi të gjitha reformën agrare. Megjithatë ekziston ky nen, nuk është realiste të mendojmë për aplikimin apo ekzekutimin e tij, të paktën në epokën aktuale, duke marrë në konsideratë marrëdhënien e forcave politike ekzistuese sot dhe mungesën e partive politike moderne me ideologji të favorshme për sa i përket ndryshimit social.

Duke marrë në konsideratë faktin që Kolumbia përjeton një problem tepër të rëndë, atë të fëmijëve të braktisur, fenomen ky fatkeqësisht i përbashkët i shume vendeve të Amerikës Latine, Kushtetuta e re i dedikon të drejtave themelore të fëmijëve nenin 44, që mes të tjerave ka aspektin pozitiv që liston dhe qartëson ato, gjë që nuk ndodh me të drejtat themelore të subjekteve të tjerë. Nga kjo renditje duhen përmendur të drejtat e fëmijëve për t'u ushqyer në mënyrë të ekuilibruar, e drejta për të patur një familje, e dashurisë, e mbrojtjes kundër çdo forme braktisje, dhune fizike ose morale, sekuestrim, abuzim seksual, shfrytëzim ekonomik apo në punë.

Duke ndjekur hapat e Kushtetutave të tjera latino-amerikane, ajo kolumbiane e viti 1991 ka dashur t'i dedikojë një nen të drejtës së banesës (neni 51). Shembulli i Kushtetutës Sovjetike të viteve gjashtëdhjetë për të aplikuar të drejtën e të gjithë personave për të zotëruar një banesë private, është imituar nga ato vende që për shumë dhjetëvjeçare nuk kanë mundur të tejkalonin problemet e mungesës së zhvillimit dhe aq më tepër nuk kanë realizuar reforma të mëdha si për shembull ajo urbane; kjo reformë është baza e zgjidhjes së problemit të rëndë të banimit që prek Amerikën Latine. Mund të pohojmë se kjo e drejtë përbën, pra, vetëm një dëshirë me rrezikun se mund të transformohet në një shembull retorike kushtetuese.

Në fushën e lirive fetare dhe të kultit kushtetuta e re ka ecur përpara me nenet 18 dhe 19 të cilët garantojnë lirinë e koshiençës dhe të kultit dhe barazinë e të gjitha besimeve fetare përpara ligjit. Në fushën e martesës dhe divorcit, Kushtetuta (neni 42) ka sjelle supremacinë e ligjit civil mbi legjisllacionin fetar, duke disponuar në këtë mënyrë që efektet e ligjit civil të çdo martesë do të ndërpriten me divorcin, sipas ligjit civil.

Një hap i rëndësishëm në fushën e garancive dhe realizimit të të drejtave kushtetuese përfaqësohet edhe nga neni 84, i cili disponon që një e drejtë ose veprimtari që janë të disiplinuar në përgjithësi nuk kërkojnë për ushtrimin e tyre asnjë autorizim, kërkesë apo ndërhyrje të mëtejshme të autoriteteve publike; në këtë këndvështrim, janë menjëherë të aplikueshme të gjitha të drejtat kushtetuese themelore.

Një gjykim i përgjithshëm mbi titullin e të drejtave është pozitiv edhe pse aplikimi mbetet akoma parcial. Mund të pohojmë megjithatë, që është më mirë të kemi të gjitha këto të drejta të shkruara në kartën kushtetuese se sa të mos ishin as të përmendura në të. Madje, duhet të besojmë në funksionin edukativ të normave.

4. Garancitë kushtetuese në Peru

Konstitucionalizmi i Amerikës Latine është i karakterizuar, që nga origjina e tij nga institucione që janë të drejtuara për garantimin e lirive themelore të njeriut, si amparo dhe mbrojtja. Me këtë qëllim, Peru-ja paraqet një kushtetute aktuale gjashtë mekanizma mbrojtjeje të lirive themelore: aksioni i habeas corpus -it, me një origjinë anike angleze dhe spanjolle; aksioni i amparos dhe habeas data -s se bashku me aksionin e antikushtetueshmërisë, aksionin popullor dhe aksionin e veprimit.

Aksioni i amparos ose i mbrojtjes kundër veprimeve apo mosveprimeve të çdo autoriteti, funksionari apo personi privat, që prek apo cenon çdo të drejtë të njohur nga Kushtetuta, ndryshe nga e drejta individuale dhe nga të drejtat kushtetuese të lidhura, të cilat garantohen nga aksioni i habeas corpus -it, si dhe nga të drejtat e mbrojtura me aksione juridiksionale specifike.

Aksioni i habeas data -s vepron kundër veprimit apo mosveprimit nga ana e çdo autoriteti, funksionari ose personi privat, që prek apo cenon të drejtën e çdo personi për të kërkuar, pa përmendur arsyen, informacionin që dëshiron dhe ta marrë atë nga çdo ent publik, brenda afatit ligjor, me përjashtim të rastit kur informacionet prekin intimitetin personal dhe ato shprehimisht të përjashtuara nga ligji ose për motive sigurie kombëtare. Precizohet se sekretet bankare mund të ndërpriten me kërkesë të gjyqtarit, të Prokurorit të Përgjithshëm (Taks Forca) ose e një Komisioni Hetimor të Kongresit. Habeas data procedon edhe në rastet që lidhen me të drejtën me qëllim që shërbimet informatike, kompjuterike, publike apo private, mos të racione të rrëfejnë informacione të pasakta apo ofenduese të nderit, reputacionit të mirë, intimitetit personal, familjar dhe të imazhit, me të drejtën konsekuente për t'i ratifikuar falas, në mënyrë direkte dhe proporcionale.

Aksioni i antikushtetueshmërisë procedon kundër normave të një rangu ligji, dekreti legjislativ, dekreti urgjent, traktate, rregullore të Kongresit, si dhe norma rajonale me karakter të përgjithshëm dhe urdhra komunale, në rastin kur janë në kundërshtim me Kushtetutën në formë dhe substancë. Nga ana tjetër, aksioni popullor procedon, për shkelje të Kushtetutës dhe të ligjit, kundër rregulloreve, normave administrative, si dhe zgjidhjeve dhe dekretive me karakter të përgjithshëm, të lëshuara nga çdo autoritet.

Mund të propozojnë aksionin e antikushtetueshmërisë: Presidenti i Republikës, Prokurori i Kombit, Avokati i Popullit, 25% i numrit ligjor të anëtarëve të Kongresit; në fushat e kompetencës së tyre: Presidenti i Rajoneve me marrëveshje të Këshillit dhe Kolegjeve Profesionale. Ky aksion duhet të paraqitet nga jo më pak se 5.000 shtetas (Kushtetuta e mëparshme

kërkonte 50.000). Si kontrast, duhet të nënvizohet fakti se në konstitucionalizmin kolumbian mjafton vetëm një shtetas për të nisur aksionin.

Gjithashtu, aksioni funksionon si një garanci juridikionale që siguron bindjen ndaj normave ligjore ose ndaj akteve administrative nga ana e një autoriteti ose e një funksionari.

5. Të drejtat e njeriut, detyrat dhe garancitë në Venezuelë

Në Titullin e III të Kushtetutës së re, Venezuela mori të gjithë eksperiencën e fushës së vendeve më të rëndësishme të Amerikës Latine nga fundi i viteve '80 deri më sot. Në këtë periudhë pjesa më e madhe e vendeve kanë përjetuar lindjen e demokracisë, të paktën e asaj formale, mbi bazën e mbetjeve politike që kanë lënë diktaturat ushtarake të Kepit të Jugut (Argjentine, Brazil, Uruguay, Kili, Paraguay), të vendeve andine Ecuador, Bolivi, Peru, dhe të vendeve të Amerikës Qendrore, El Salvador, Nikaragua dhe Guatemala, të njohura në histori për historinë e trishtë të shkeljeve pa limit të drejtave njerëzore. Mjafton të mendojmë fenomenin e “desaparecidos”. Me demokracinë hapet edhe një etapë e re për të drejtat njerëzore dhe miratohen në të gjitha kushtetutat e reja latino-amerikane të drejta dhe garanci të reja, si amparo, habeas data, të drejtat mjedisore, të konsumatorit, të drejtat e pjesëmarrjes në administratën publike, kontrolli i qeverisësve, avokati i popullit, për të përmendur disa nga më të rëndësishmet.

Ndryshimet më të rëndësishme të kushtetutës së fundit venezuelane në këtë fushë mund të përmblihen në këto pika:

Perfeksionohen normat mbi të drejtat e njeriut duke i vendosur në një rang kushtetues me dispozitat e traktateve ndërkombëtare mbi këtë fushë dhe me parimin e progresivitetit. Në këtë kuptim, katalogu i të drejtave dhe garancive të përmbajtura në kushtetutë nuk përfaqëson një limit apo mohim të të tjerëve që lidhen me personin dhe traktatet, paktet dhe marrëveshjet në fushën e të drejtave të njeriut, të firmosura dhe ratifikuara nga Venezuela, kanë hierarki kushtetuese dhe mbizotërojnë në sistemin juridik të brendshëm, në sensin se ato janë më të favorshme se normat e vendosura nga Kushtetuta dhe ligjet, për gëzimin dhe ushtrimin e të drejtave, duke qenë se kanë aplikim direkt nga gjykatat dhe nga organet e tjera shtetërore.

Krijohet e drejta e amparo -s ose mbrojtjes, si garanci juridikionale edhe e atyre të drejtave që nuk janë përmendur shprehimisht në kushtetutë, nëpërmjet një procedimenti oral, publik, të shkurtër, të thjeshtë në të cilin gjyqtari kompetent ka pushtet për të vendosur menjëherë situatën juridike të shkelur ose atë që i përafrohet më shumë. Aksioni mund të paraqitet dhe gjyqtari në çdo moment duhet t'a trajtojë atë në mënyrë preferenciale.

Mbi kombësinë dhe shtetësinë normat kushtetuese kanë ndryshuar mbi të gjitha duke lejuar shtetësinë e dyfishtë: nuk e humb shtetësinë venezuelane personi që merr një shtetësi tjetër. Gjithashtu, parashikohet për të huajt një periudhë rezidence në territorin vendas prej të paktën dhjetë vitesh për të kërkuar natyralizimin, por për shtetasit latino-amerikane, spanjolle dhe italiane këto afate zvogëlohen në pesë vite, ashtu si për bashkëshortet e një shtetasi apo shtetase venezuelane.

Për sa i përket të drejtave të shtetasit, në radhë të parë, parashikohet që venezuelanet për adoptimin gëzojnë të njëjtat të drejta, por nuk mund të zgjidhen apo emërohen: presidenti dhe zëvendës presidenti i Republikës ose Asambleja Kombëtare; gjykatësi i Gjykatës Supreme të drejtësisë, Prokuror i Përgjithshëm, Kontrollor i Përgjithshëm; ministër për çështje që lidhen me sigurinë, financat, energjinë dhe minierat, arsimin; guvernator apo kryetar bashkie të shteteve dhe komunave të kufijve; oficer i lartë i forcave të armatosura.

Në lidhje me të drejtat civile konfirmohet barazia e plotë e personave dhe zgjerohen përgjegjësitë e Shtetit në mbrojtjen e personave që ndodhen në burg, duke ushtruar detyrat ushtarake apo civile, ose në çdo formë tjetër të nënshtuar në autoritetin e tij. Rrjedhimisht lind ndalimi për autoritetet publike, civile ose ushtarake, të praktikojnë, lejojnë ose tolerojnë zhdukjen e forcuar të personave, krim për fat të keq i shpeshtë në kontinentin latino-amerikan jo vetëm për arsye politike por edhe të krimin.

Konkluzione

Garancitë kushtetuese përbëjnë thelbin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore. Gjithashtu ato sigurojnë mjete procesuale në rast cenimi apo ndërprerje të këtyre lirive dhe të drejtave themelore të shtetasve. Ky studim krahasues ka si qëllim kryesor evidentimin e faktorëve pozitive për shtetasit e Amerikës Latine si rrjedhojë e garantimit të lirive dhe të drejtave të tyre në çdo kohë, gjithashtu edhe qasjen e ligjvënësit tonë kushtetues për një rishikim kushtetues në lidhje me garantimin në çdo kohë dhe situatë të të gjitha lirive dhe të drejtave të sanksionuara nga vetë Kushtetuta. Kjo është një sfidë e ligjvënësit tonë kushtetues në vitet në vijim.

Neni 175 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë citon se «Gjatë gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme nuk mund të kufizohen të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 12, 18, 19, 20, 21, 24, 25, 29, 30, 31, 32, 34, 39 paragrafi 1, 41 paragrafët 1, 2, 3 dhe 5, 42, 43, 48, 54, 55». Pra mbrohen e drejta e barazisë, jeta e individit etj.

Paragrafi i dytë i këtij neni citon: «Gjate gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të kufizohen të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 37, 38, 41 paragrafi 4, 49, 51».

Pra, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë kufizon një serë të drejtash dhe lirish në rast fatkeqësie natyrore. Detyra e një shteti është ajo e mbrojtjes dhe garantimit të të gjitha të drejtave dhe lirive individuale në çdo kohë dhe përpara çdo vështirësie që i kanoset individëve të tij. Pezullimi apo ndërprerja e disa garancive kushtetuese, siç e ka treguar qartë historia e hidhur e viteve të kaluara në vendin tonë, është një pushtet i dhënë nga Kushtetuta i cili mund të përdoret në mënyrë arbitrare nga pushteti. Qëllimi i këtij studimi krahasues është pikërisht reflektimi mbi cenimet e mundshme të garancive tona kushtetuese në raste të jashtëzakonshme dhe mundësia e një rishikimi kushtetues për mbrojtjen dhe garantimin universal të lirive dhe të drejtave individuale që rrjedhin nga vetë Kushtetuta.

Bibliografia

- Habeas Corpus, amparo, habeas data y acciòn de cumplimiento: normatividad vigente, Lima, Comisiòn andina de Juristas, 1994
 El derecho a la tutela judicial efectiva y el amparo constitucional, Civitas, Madrid, 1995.
 Garantias jurisdiccionales para la defensa de los derechos humanos en Iberoamerica, Unam, Mexico, 1992.
 Kushtetuta e Kolumbisë
 Kushtetuta e Perusë
 Kushtetuta e Venezuelës
 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

LEGJISLACIONI MJEDISOR. LIGJI PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE, DHE KUSHTETUTA

ARTAN MANUSHAQE

Ph.D candidate (UET)

EUGENA BISHA

Ph.D candidate (UET)

ABSTRAKT

Ky punim ka për qëllim të evidentojë problematikat që ka legjislacioni mjedisor në Shqipëri në lidhje me përdorimin dhe menaxhimin e ujërave, duke bërë një analize të hollësishme ligjore të përdorimit të ujërave, që kanë ndikim ekonomik – sociale, dhe mjedisore. Punimi trajton edhe aspekte të legjislacionit ndërkombëtar në fushën e mjedisit me drejtim Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore (LMIBU). Gjithashtu ky punim shkencorë synon të bëjë dhe rekomandimet, për ligjin nr. 111/2012 për “Menaxhim e Integruar të Burimeve Ujore” si një ligj i cili nuk përshtatet me Konceptin e Zhvillimit të Qëndrueshëm për përdorimin e burimeve ujore. Ligji për MIBU në nenin 39 pika 4 bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me nenin 59 pika “dh” të saj.

Pyetjet Kërkimore: Cili është roli i Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore në Mbrojtje të Mjedisit? A është ky ligj antikushtetues? A përputhet me Konceptin e Zhvillimit të Qëndrueshëm? Për ti dhënë përgjigje nëpërmjet këtij hulumtimi shkencor ligjor, janë përdorur metodologjitë, analitike, krahasimore, dhe interpretuese.

Punimi është i ndarë në krahë, ka hyrjen, historikun, analizën ligjore dhe të veprimtarive të caktuara në përdorimin e ujërave. Mbyllet në fund me gjetje, rekomandime të ligjit për të mbrojtur përdorimin dhe menaxhimin e ujërave, si dhe për të garantuar një Zhvillim të Qëndrueshëm të Shqipërisë, duke sjellë në harmoni tre dimensionet e zhvillimit: ekonomia, shoqëria dhe mjedisi si tre elementë jetësorë të pandarë që lidhen me shëndetin e njeriut.

Fjalë kyç: *ligji, mjedisi, përdorim i ujit, koncesionari, zhvillim i qëndrueshëm.*

Kreu I

1-1 Hyrje

Ndryshimet që po pëson klima sot në botë, nuk ka vetëm faktorin natyrë që ndikon, por një pjesë e rëndësishme është edhe veprimtaria njerëzore, e cila e ka përkeqësuar ndjeshëm mjedisin duke e shfrytëzuar në maksimumin e saj. Shqipëria si një vend i izoluar mbas viteve nëntëdhjetë u fut vrullshëm në ekonominë e tregut të lirë, e cila për fat të keq e ka shkatërruar mjedisin, i cili përbëhet nga dy element, ai natyrorë dhe socialë. Zhvillimi i Qëndrueshëm i dalë nga Organizata e Kombeve të Bashkuara 2001 Johansburg, nënkupton bashkëjetesën e 3 principeve, ekonomi, shoqëri, dhe mjedis. Të gjitha këto duhet të ecin si një trinom i pandashëm dhe në funksion të njëra - tjetrës për t'i shërbyer shëndetit të individit dhe mjedisit që e rrethon. Prioriteti i politikave ekonomike në Shqipëri në 2008 ishte ajo e një superfuqie energjetike, e cila bazohej kryesisht në shfrytëzimin e burimeve ujore, të lumenjve, përrrenjve, priskave etj., në ndërtimin e Hidrocentraleve (HEC-e).

Që nga ajo kohë e deri tani janë dhënë rreth 400 leje për këtë veprimtari ku rreth 140 prej tyre janë në aktivitet. Jo të gjitha këto veprimtari janë të dëmshme për mjedisin por pjesa më e madhe e tyre bien ndesh, me ligjin dhe Kushtetutën. Në kushtet kur Shqipërisë po i cenohen dhe janë cenuar rrjedhat ujore natyrore të garantuara nga Konventa e Espositit, Konventa e Helsinkit, Direktivat e BE, Konventa e Rios dhe shumë Konventa apo akte ndërkombëtarë, ne si qytetar të këtij vendi jo vetëm na lind detyrimi për t'i mbrojtur këto ujëra por edhe për t'i menaxhuar në mënyrë më efikase, kur shikojmë edhe ndryshimet jo normale të motit, me përmbytjet në Rajonin e Shkodrës në vitin 2010 dhe ato të Rajonit të Vlorës 2015. Ligji për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, në nenin 39 pika 4 është antikushtetues, dhe bie në kundërshtim me pikën "dh" të nenit 59 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

1-2 Objektivat e këtij studimi

Objektivat e këtij studimi janë: të evidentojë, analizoje, përcaktojë, dhe rekomandojë zgjidhje për mënyrën e përdorimit/ menaxhimit të burimeve ujore në Shqipëri. Të mbrohet Mjedişi dhe shëndeti. Të informohen qytetarët. Të shfuqizohet pika 4 e nenit 39 të Ligji për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, si antikushtetuese. Të përcaktohet një moratorium për mos ndërtimin e HEC-eve për të paktën 5 vjet. Të pezullohen lejet që janë në kundërshtim me ligjin, që ushtrojnë veprimtari faktike. Të mos lejohet fillimi i veprimtarive për ndërtimin e HEC-eve, për ato leje që s'kanë filluar ushtrimin e veprimtarisë. Të pezullohet veprimtaria në Lumin dhe Kanionin e Langaricës.

1-3 Pyetja kërkimore

Sa efektiv është Ligji 111/2012 për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore në shfrytëzimin e burimeve ujore (MIBU)? A është ky ligj në përputhje me Kushtetutën? A përputhet me Konceptin e Zhvillimit të Qëndrueshëm? A mbron dhe garanton një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm?

1-4 Hipoteza

Ligji 111/2012 për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore në shfrytëzimin e burimeve ujore, në nenin 39 pika 4 e tij, nuk garanton një përdorim racional të burimeve ujore në Shqipëri, pasi i jep mundësinë koncesionarit ta shfrytëzojë në maksimumin e tij këtë rrjedhë ujore, dhe në kushtet e thatësisë, prevalon supermacia e Interesit Privat dhe jo atij Publik, edhe pse Kushtetuta i garanton mbrojtje të dy palëve². Për këtë arsye ai është në kundërshtim me nenin 59 të Kushtetutës pika "dh" e tij. Mospërputhja me Kushtetutën si norma më e lartë juridike në vend e ligjit MIBU, cenon drejtpërsëdrejti Interesin Publik, rrjedhimisht edhe Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe nuk garanton një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm për brezat e tanishëm dhe të së ardhmes, si dhe lidhet drejtpërsëdrejti me anëtarësimin tashmë si vend kandidat (në pritje të hapjes së negociatave) të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

1-5 Metodologjia e Studimit

Hulumtimi Shkencor në fushën e ligjit, fushën e mjedisit, në fushën e së drejtës Kushtetuese, dhe akteve ndërkombëtarë, bazohet mbi metodologjitë, analitike, krahasimore, interpretuese.

¹ Konventa e Esposit (Finlande) për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekstin Ndërkufitar, është miratuar në 1991 dhe ka hyrë në fuqi në shtator 1997.

² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë neni 42.

Kreu II

2-1 Analiza

Mbas marrjes së informacionit në rrugë mediatike dhe ligjore për ndërtimin e një HEC-i në Kanionin e Lengaricës (Përmet, Komuna Petran) jemi njohur me Raportet Studimore dhe Mjedisore, që dëftojnë për teknikat dhe mekanizmat ligjore të funksionimit të disa HEC-eve përgjatë kaskadës së Lumit Langaricë në rajonin e Përmetit. Iniciativa e marrë nga:

Prof. Sazan GURI ekspert gjeomjedisi; Dr. Lavdosh FERRUNAJ ekspert mjedisi; Prof. dr. Alfred FRASHËRI ekspert gjeofizik; Prof. dr. Kristo GOGA ekspert hidroteknik; Prof. dr. Farudin HOXHA ekspert hidroteknik & diga; Inxh. dipl. Engjëll CICI ekspert hidroteknik & diga; Dr. Faruk KABA ekspert i infrastrukturës rrugore; Av Kondi ILIA; duke u bazuar si fillim dhe në VKM-n nr. 16/31, dt. 17.12.2008 por edhe si ekspert të fushës së hidrogeologjisë, si ekspert të hidroteknikës dhe digave, si ekspert mjedisor nisën kryesisht një hetim për sa i përket veprimtarisë së këtij HEC-i, në këtë zonë që përfaqëson një nga zonat me eksosistemin më të brishtë të vendit, ku ndodhen pesë pasuri të mëdha natyrore që lidhen apo ndikohen direkt me aktivitetin e veprës së marrjes së ujit si:

Bredhi i Hotovës – Dangëlli, Shpallur Park Kombëtar me VKM nr 16/31, dt 17.12.2008
Kanioni i Lengaricës;
Ujërat Termalë të Bënjës me tetë burime të tilla;
Shpella e Pëllumbit, dhe 15 shpella të tjera, shtëpi parahistorike të njerëzimit;
Guri i Petranit.

Këto përbëjnë veç e veç zona të mbrojtura (të kategorive dy, tre dhe katër), dhe ndodhen brenda zonës së mbrojtur të kategorisë së dytë, si ajo “Bredhi i Hotovës”. Njëkohësisht, në to ndodhen objektet e trashëgimisë kulturore, si “Ura e Katiut”, “Ura e Dashit”, monumente kulture të kategorisë së parë, bashkë me Shpellën e Pëllumbave. Le t’i marrim me radhë shkeljet e bëra në këtë rajon sa të ndjeshëm dhe të brishtë:

2-2

Për Parqet Kombëtare të Kategorisë së dytë, si zona e Parkut Kombëtar Bredhi i Hotovës, sipas Nenit 6 të ligjit të Për Zonat e Mbrojtura, i ndryshuar, zbatohen të katra shkallët e mbrojtjes, ku sipas pikës “a” ndalohet shfrytëzimi i tokës me teknologji intensive, me mjete dhe mënyra që shkaktojnë ndryshime rrënjësore në biodiversitet, në strukturën dhe funksionet e ekosistemeve ose që dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme sipërfaqen e tokës; dhe sipas pikës “d” të këtij neni thuhet shprehimisht se “ndalohet ndërtimi i rrugëve, autostradave, hekurudhave, zonave urbane, linjave të tensionit të lartë dhe sistemeve të naftës dhe gazit me shtrirje të gjatë”. Në fakt ka ndodhur e kundërta, ku në fakt duhej për promovimin e turizmit drejt Kanionit të Lengaricës dhe Banjat e Bënjës, aty u panë kamionë të rëndë, që punojnë për Hidrocentralin në një zonë të ndaluar me ligj, e cila nuk duhet shqetësuar në mënyrë kategorike nga këto lloj punimesh dhe kjo veprimtari. Për sipërfaqen më të madhe të këtij Parku Kombëtar, që çahet mes për mes nga aktiviteti ndërtues dhe funksional i veprës ujore, zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, ku vendimi nr.1631, datë 17.12.2008s e identifikon dhe e përkufizon si një territor të pa shqetësuar. VKM-ja, shprehet që për rastet e trashëgimisë kulturore, jepet leje nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

2-3

Për Shpellën e Pëllumbit, Kanionin e Lengaricës dhe Bredhin e Petranit, të njohura dhe të mbrojtura si Monument Natyrore të kategorisë së tretë, nga Neni 7, pika 2, përcaktohen si monumente natyrore ku zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, pra si territore të pa shqetësuar, dhe Neni 18, pika 5 thekson se këto Monumente Natyrore, si pronë publike, janë të patjetërsueshme (ndërkohë që ato tjetërsohen), dhe/ose duke mos patur ujin, iu humbet vlera për të cilën ato ekzistojnë. Sepse, neni 3, pika 11, i Ligjit të ZM 6, na dikton se “Kanion” nënkupton një grykë të thellë, me shpate të rëna thikë, të krijuar nga proceset fiziko - natyrore, në bazën e së cilës, përgjithësisht, rrjedhin ujërat sipërfaqësore.

2-4

Për Llixhat ose Ujërat Termalë të përcaktuara si Rezervat Natyror i Menaxhuar, Neni 9, pika a, shprehet tekstualisht se “ndalohen ndryshimet e gjendjeve natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura. Kësisoj,

KËRKESË Lënda: Për anulimin e punimeve të zbatimit për HEC-in në Lumin e Lengaricës, Përmet. Tiranë, më 21.10.2014 Drejtuar: Presidentit të Republikës, Kryeministrit të Republikës Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Bankës Botërore, Komisioneve Parlamentare, nga ZQMM (Zyra qytetare e Mbrojtjes së Mjedisit.

Ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 «Për zonat e mbrojtura», i ndryshuar.

VKM nr.1631, datë 17.12.2008

Ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 «Për zonat e mbrojtura», të ndryshuar

tetë Llixhat e Banjës në këtë lumë do të preken direkt nga furnizimi me ujë prej lumit Lengaricë, në rastin kur atij i lihen rreth 2,5% ose 0.2 m³ ujë për sekondë ⁷ të sasisë natyrore, çka përbën një rrezik real për zhdukjen e kësaj pasurie natyrore, duke i marrë rrjedhës nga 5000 – 8000⁸ litra metro kub ujë për sekond, më shumë së 97-98 % të rrjedhës së prurjeve mesatare shumëvjeçare.

2-5

Studimet nuk kanë kryer llogaritjet e krahasuara (Benefit & Cost) midis alternativës me HEC-e dhe alternativës me prioritetet turistike që burojnë nga potencialet e stisura të natyrës. Një llogaritje e tillë do të na siguronte mundësinë e përfitimit dhe të humbjeve, si në njërin rast dhe në tjetrin, si dhe masat kompesuese për secilin rast.

Gjithashtu në bazë të dokumentacionit sqarojmë se nuk është kryer ndonjë studim, që të rezultojë se cila është sasia e ujit që nevojitet domosdoshmërisht për jetesën e gjallesave në këto ujra, nëse ato mund të mbijetojnë me një sasi uji prej 0.2 m³ në sekondë përgjatë një shtrati që thahet krejtësisht. Ndërkohë që Leja Mjedisore Nr. 318/1 lëshuar nga Ministria e Mjedisit datë 11.02.2007⁹ ngarkon subjektin përdorues “Të respektojë normat e shfrytëzimit të burimeve hidrike sipas studimit të paraqitur, duke ruajtur nivelin e mjaftueshëm të ujërave që shfrytëzohen për gjallesat që jetojnë në to.

Për më tepër, kjo leje specifikon që të ruhet dhe të mos preket plazhi mbi Lumin Lengaricë. Në fakt i gjithë ky plazh preket, sepse në të nuk do të ketë fare ujë. Theksojmë se, jemi vënë në dijeni të shkresës, Nr. 44 Prot. të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Qarku Gjirokastrë, datë 04.10.2006¹⁰, ku kërkohej nga kjo e fundit dhënie mendimi nga Ministria e Mjedisit për lëshim leje, në fakt jo për Hidrocentral, por për aktivitetin, shfrytëzim të ujërave Termominerale dhe Kurative të Banjave të Bënjës, që do të kryej nga subjekti përdorues i ujit. Ligji “Për Ndikimin në Mjedis” ndalon në mënyre kategorike ndryshimet e projekteve në këtë mënyrë, edhe pse projekti ndryshoi nga kompleks vilash në HEC dhe me shtesa në kontrata pa u informuar publiku i zonës¹¹, informimi me publikun u bë për lejen zhvillimore me objekt, komplekse vilash në Banjat e Bënjës jo për HEC-et.

Gjithashtu, Leja Mjedisore datë 17.01.2012/ Nr. 318/1 Prot. kërkon që të evitohet në mënyrë kategorike hapja e rrugëve të reja dhe të përdoret rrjeti rrugor ekzistues, duke e mirëmbajtur vazhdimisht. Në këtë zonë, detyrimet e përcaktuara nga leja mjedisore janë shkelur, sepse sapo hyn në Banjat e Bënjës është ndërtuar një urë betoni që krijon një kontrast të papranueshëm me urën mesjetare, si dhe është hapur një rrugë e re duke shpyllëzuar dhe duke prishur një peizazh të virgjër. Bazuar në shkresën Nr. 8786, Prot. datë 28.12.2012, ¹² AKBN vëren se zona ku parashikohet të ndërtohet HEC-i “Lengarica” shtrihet në qytetin e Përmetit. Sipas projektit të zbatimit parashikohet të ndërtohet vetëm një hidrocentral “Lengarica 1” dhe jo dy Hidrocentrale “Lengarica 1 dhe 2” sipas kontratës koncesionere nga ana e subjektit përkatës të cilit i është dhënë e drejta e përdorimit të këtyre ujërave. Referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Neni 59¹³, pika dh, thekson se, Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Duke qenë se nuk lihet sasia e duhur për ekuilibrin ekologjik, bujqësor dhe njerëzor, mendojmë se prishet ekuilibri jetik në rastin e aktivitetit të përdoruesit të ujit. Referuar, Neni 203, ndotja e ujërave, në Kodit Penal vërejmë se vepra ujore shkakton pasoja të rënda për jetën e shëndetit të paktën 5000 banorëve të Komunës Petran, Përmet, për shkak se lehtas vërtetohet prishja e ekuilibrit ekologjik, në rastin e lënies së ujit prej 0.2/ m³ ujë në sek në rrjedhën natyrore të Lumit Lengaricë apo marrjes së 5000 – 8000 litra ujë për/sek prej saj. Studimi i vitit 2002 i Institutit Gjeologji Minerave dhe ujërave në Fier¹⁴, përcakton se zona e Lengaricës, Banjat e Bënjës, Kanioni, lumi saj, në tërësinë e tyre duhet të jenë të pa shqetësuara nga veprimtari apo vepra ndërtuese energjetikë, etj, me intensitet të lartë, me arsyetimin sepse kjo dëmton mjedisin, faunën, nëntokën, ekosistemin, dhe shumë dëme të tjera që i vijnë mjedisit të kësaj zone.

2-5-1

Në kuadrin e konceptit “Ndotje dhe Ndotës” të përcaktuar në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr. 10431, datë 09.06.2011 Neni 5, pika 10 dhe 15 dhe Neni 12 e në vijim, sipas Parimit “Ndotësi paguan”, personi fizik apo juridik, me veprimet ose mosveprimet e të cilit ndikojnë në ndotjen e mjedisit, mban përgjegjësi financiare si në rastin Lengaricë, duke përballuar kostot e shkaktuara nga ky dëmtim apo rrezik për dëmtimin e mjedisit.

2-6

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 56 thekson:

Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij¹⁵. Po kështu neni 624 i Kodit Civil përcakton

<http://www.reporter.al/hidrocentrali-financuar-nga-banka-boterore-kercenon-kanionin-e-lengarices/>

Leje Mjedisore Nr. Identifikues 437, prot 318. Tiranë, më 17.01.2012

Leja Mjedisore Nr. 318/1 lëshuar nga Ministria e Mjedisit datë 11.02.2007

Nr 44 Prot, të Agjencisë Rajonale e Mjedisit Qarku Gjirokastrë, datë 04.10.2006,

VKM nr 543, datë 01.05.2008 Ministri Ekonomisë Tregëtisë dhe Energjitikës z Genc Ruli

Shkresë Nr. 8786, Prot. datë 28.12.2012, Agjencia Kombëtare e Burimeve

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 59, pika d

Modeli Gjeodinamik dhe strukturorë, i gjeokonstrukcionit. Fier, Dhjetor 2002. Studim tërsor, UPA, Fier, 2002. Autor : Prof Sazan Guri,

Andrea Toska (Ministria e Industrisë dhe Energjitikës)

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 56

se personi që me faj ka cenuar mjedisin¹⁶, duke e keqësuar ndryshuar ose dëmtuar atë, tërësisht ose pjesërisht, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar, në vijim të Konventës së AARHUS-it, e cila është ratifikuar nga Shqipëria që në vitin 2000 dhe është e detyrueshme të zbatohet, sepse është shkëlur E Drejta e Publikut për t'u Informuar¹⁷ në Nenin 4 të kësaj Konvente, për rrjedhje edhe procedurat e mëpasme janë të pavlefshme, pasi cenohet e drejta për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Nga provat dhe faktet e deritanishme që disponojmë rezulton se në datën 04.07.2013¹⁸, është lëshuar Vendimi Nr. 6, nga Këshilli Kombëtar i Territorit, me qëllim Miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse të Hidrocentralit, e lëshuar më datë 20.02.2014¹⁹ nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë. Këto akte janë dhënë në kundërshtim me ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”. Më konkretisht, neni 38 i këtij ligji shprehet se “Çdo vendim i marrë nga Këshillat e Rregullimit të Territoreve për ndërhyrje ose ndërtim në zonat e shpallura monument kulture ose në zonën e mbrojtur pranë një monumenti kulture, pavarësisht nga pronësia, është i pavlefshëm”. Në bazë të këtij ligji (neni 24/ç) dhe akteve nënligjore në fuqi, Shpella Prehistorike e Pëllumbave dhe Ura Mesjetare e Katiut janë shpallur Monumente Kulture të Kategorisë së 1-rë. Në bazë të provave që kemi në dispozicion është shkëlur hapur ligji “Për trashëgiminë Kulturore” në dispozitat e mëposhtme që po i rendisim:

Neni 8 parashikon se çdo person fizik ose juridik është i detyruar të ruajë, sipas kritereve të caktuara në këtë ligj dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, tërësinë e vlerave të trashëgimisë kulturore e historike, që zotëron ose merr në përdorim gjë që nuk ka ndodhur në rastin konkret.

Neni 28 “Monumente Kulture të kategorisë 1-rë, janë ndërtimet me vlera të spikatura dhe me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore. Ato ruhen në tërësinë e përbërësve të tyre arkitektonike dhe teknike”.²⁰

Neni 28/2/3 për më tepër thekson se “Kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme dhe të brendshme, si dhe zgjidhja planimetricke dhe funksionale e këtyre monumenteve nuk mund të ndryshohen” si dhe “Ndërtimet e reja pranë tyre duhet të respektojnë distancat e zonës së mbrojtur”.

Neni 32/1 parashikon “Për monumentet e kulturës përcaktohet një sipërfaqe toke ose trualli përreth, si zone mbrojtëse, në përputhje me vlerat e tyre arkitektonike, me përshtatshmërinë e tyre urbanistiko-estetike, me rrethinën dhe me rrethanat ekologjike. Në këtë zonë ndalohet çdo ndërhyrje me karakter ndërtimor.”

Kreu III

3-1

Pikërisht gjatë kërkimeve të bëra në lidhje me këtë veprimtari në fushën e shfrytëzimit të burimeve ujore, përveçse kemi hasur një sërë shkeljesh të ligjit material dhe atij procedural në ushtrimin e kësaj veprimtarie, duke filluar që nga marrja e masave për informimin e publikut gjë që nuk është bërë në mënyrë të plotë dhe të saktë sipas ligjit për të drejtën e informimit, nr.8503, date 30.6.1999²¹, për të vazhduar me mos respektimin e kontratës mbi të cilën janë shtuar anekse, rrjedhimisht edhe objekti i shtuar dhe i ndryshuar pa u informuar publiku i prekur nga aktiviteti i përdoruesit të ujit në atë zonë. Ligj nr. 111/2012 për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore në Neni 1 shpreh Qëllimin e tij:²² Ky ligj ka si qëllim: a) mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare, të ujërave territoriale, zonave ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkuftare, të ujërave nëntokësore, si dhe të statusit të tyre; b) sigurimin, ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore, të domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin social e ekonomik të vendit; c) shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore, sipas qëllimeve të përdorimit dhe drejtimin e administrimit e efektshëm të tyre; ç) mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja, shpërdorimi dhe harxhimi mbi nevojat faktike; d) përcaktimin e kuadrit institucional, në nivel kombëtar e vendor, për vënien në jetë të një politike kombëtare për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore në të mirë të komunitetit dhe interesave sociale dhe ekonomike të vendit.

Problemi shfaqet më tej kur në nenin 39 pika 4 e këtij ligji thuhet:

Neni 39 Përdorimi i burimeve ujore. 1. Përdorimi i burimeve ujore natyrore i nënshtrohet kontrollit administrativ nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore dhe inspektimit nga inspektorët që mbulojnë fushën e mjedisit. 2. Çdo përdorues i ujit është i detyruar që në rrjedhën natyrore të lejojë rrjedhjen minimale ekologjike, duke mos e përfshirë atë në sasinë e ujit që është i autorizuar të përdorë. 3. Sasia e rrjedhjes minimale ekologjike për çdo trup ujor natyror përcaktohet sipas planeve të menaxhimit të baseneve dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, duke u bazuar në karakteristikat specifike dhe vlerat natyrore e ekologjike që ka baseni ujor. 4. Pavarësisht nga sasia e rrjedhjes ekologjike që përcaktohet në planet e menaxhimit të baseneve, ajo nuk mund të jetë më e vogël se prurja me qëndrueshmëri 355 ditë në vit (Q355) pika 4 e nenit 39 e Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, nënkupton faktin se koncensionari në ushtrimin e veprimtarisë

Kodit Civil, neni 624

Konventa e AARHUS-it, (Danimark 1998) Ratifikuar nga Shteti Shqiptar në vitin 2001

Vendimi i KRRTRSH nr 06, datë 04.07.2013

Leje Zhvillimore Komplekse të Hidrocentralit Lengarica/1/2, e lëshuar më datë 20.02.2014

LIGJ Nr.9048, date 7.4.2003 për trashëgiminë kulturore

Ligji për të drejtën e infomimit, nr.8503, date 30.6.1999, Konventa e Aarhusit 2001

Ligj nr. 111/2012 për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore

së tij, në shfrytëzimin e burimeve ujore i lindë e drejta që të shfrytëzojë në maksimumin e tij rrjedhën ujore të lumenjve, apo burimeve të tjera ujore në funksion të veprimtarisë së tij për 355 ditë më përjashtim të 10 ditëve ku legjislatori ka lënë të kuptohet periudhat e thatësirës. Konçensionarit,²³ kur burimet ujore kanë prurje të shumta, i lindë e drejta të shfrytëzojë në kohë dhe stinë të ndryshme të vitit, por ai mund të shfrytëzojë këtë rrjedhë edhe kur ajo është nën minimumin e saj edhe si rrjedhë ekologjike, këtu dëmtohet Kanioni sepse ulen prurjet ujore minimale, kur standardet përcaktojnë se, 33% është rrjedhë ekologjike e lumit, 33% është rrjedhë që i lihet tokave bujqësore ose tokave të tjera që ndodhen nën ndikimin dhe nevojave për përdorimin e ujit, dhe vetëm në maksimumin e 33% përdoruesi ujit, konçensionari duhet të përdori këtë sasi uji, dhe përsëri kjo sasi kufizohet në periudha thatësire ose rrethana të tjera, kur pengohet rrjedha ekologjike e lumit, përrenjve, rrëqeve, apo në rastin kur 33% e ujit që u nevojitet tokave bujqësore për tu vaditur apo që janë nën ndikimin e këtyre ujërave.

3-2

Neni 59 pika dh e Kushtetutës së Republikës Shqipërisë, shprehet se : Shteti brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore²⁴ mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm;

Termi, shfrytëzimi racional i burimeve ujore, si dispozite kushtetuese, a nënkupton shfrytëzimin e burimeve ujore lumore në 100% të tyre, në 50 % të tyre, në 30% të tyre? Si mund të interpretohet neni 39 pika e katërt e Ligjit për Menaxhimin dhe Integrimin e Burimeve Ujore, në raport me këtë dispozitë kushtetuese, duke parë edhe veprimtarinë faktike të HEC-eve Lengarica 1, Lengarica 2, dhe të rreth 140 HEC-eve të tjerë në Shqipëri që ushtrojnë veprimtari në këtë fushë si dhe për 300 HEC-e të tjerë të cilët janë në proces për të filluar ushtrimin e kësaj veprimtarie. Vetë projekti Tap e ka shmangur kalimin në këtë zonë, ku thuhet:

FIGURA 6-3



Alternativa 3 (në jug) dhe Alternativa 6 (në veri)²⁵ ishin të realizueshme nga pikëpamja teknike dhe paraqisnin sfida të ngjashme të përgjithshme për ndërtimin. Gjithashtu, nuk u konstatuan ndryshime të konsiderueshme për sa i përket sigurisë dhe ndikimeve mbi aspektet socialo – ekonomike, dhe të trashëgimisë kulturore. Alternativa 6 u konsiderua se paraqiste më pak sfida për sa i përket sfidave mjedisore dhe ndërhyrjes në zonat e planifikuara nga autoritetet. Nga ana tjetër, ndërtimi i Alternativës 3 nuk do të respektonte legjislacionin shqiptar dhe të BE²⁵-së për shkak të ndikimeve të tij mbi Parkun Kombëtar Hotovë - Fir - Dangëlli, duke qenë se ajo kalon përmes Zonave me përdorim të Qëndrueshëm/Tradicional²⁶. Projekti TAP (Trans Pipilen Adriatik)²⁷ në përfundim të studimit të tij, midis kostove dhe përfitimeve në këtë zonë të mbrojtur ku bënë pjesë Bredhi Hotovës, Kanioni Lengaricës dhe shumë monumente të tjera pjesë të trashëgimisë kulturore mijëra vjeçare, apo me vlera turistike rezultuan në tërësinë e tyre më me vlerë sesa projekti i kalimit të tubacioneve të gazit të TAP²⁸. Ky projekt me një vlerë rreth një miliard euro në territorin shqiptar dhe me një rëndësi të jashtëzakonshme strategjike, ekonomike, gjeopolitike etj, respektoj legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar për sa i përket shfrytëzimit, dëmtimit të burimeve natyrore të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejta me ndotjet e mjedisit, apo prishjen e parametrave të ekosistemit në atë zonë dhe

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, Diskutim Datë 04.03.2014, ora 11:00 Fq. 9.10,11.12. Besnik Baraj, diskutim, Shkelzen Kerluku (përfaqësues i konçensionarit HEC- Lengarica)

Konventa Afrikane për Konservimin e Natyrës dhe Burimeve Natyrore (1968) në Algjeri.

Direktiva e habitateve 92/43/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit

Direktiva e BE no.409/70 mbi konservimin e zogjve të Egër

http://sq.wikipedia.org/wiki/Trans_Adriatic_Pipeline

<http://ee.tap-ag.com/the-pipeline/route-map>

më gjerë, duke ruajtur edhe Kanionin e Langaricës edhe Lumin e Lengaricës²⁹ nga dëmtimet e mundshme, ndaj faktorëve ndotës apo prishës të ekostistemit³⁰ dhe ekologjisë. Ndërkohë në këtë lumë kemi një HEC me vlerë jo më shumë se disa milion euro, ku sipas studimeve që ai ka bërë nuk cenon standardet e faunës dhe florës të ekostistemit dhe ekologjisë, kur ai shfrytëzon në maksimum rrjedhën ujore të Lumit Langaricë, devijim ose marrja e ujit e cila shmangë tërësisht Kanionin e Langaricës, dhe e bën atë jo vetëm të mos këtë ujë për rrjedhë e cila nuk plotëson kushtet që ky Kanion të jetë i lundrueshëm por edhe të këtë lagështirën e duhur që të mund të ruaj florën dhe faunën në këtë vend. Në vitin 2011 kur pronësia i kaloi një koncesionari austriak i cili aplikoi për Leje Mjedisore³¹, kjo leje nuk u miratua nga Ministria e Mjedisit, me arsyetimin se dëmton florën dhe faunën, Kanionin, Banjat e Bënjës, dhe ekostistemin e zonës. Historia e paligjshmërisë vazhdon kur kjo leje miratohet mbas 2 muajsh nga refuzimi i parë me koston e largimit të disa zyrtarëve të administratës MM nga puna, të cilët më parë e kishin refuzuar miratimin e kësaj leje si në kundërshtim me ligjin.

Kreu IV

4-1 Konkluzione dhe Rekomandime

Kur flasim për Mjedisin që jetojmë dhe na rrethon, nënkuptojmë në radhë të parë dëmtimin e shëndetit tonë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Mjedisi nuk është vetëm një ambient natyror fizik, ai është pa aq psikologjik dhe social³², prandaj duhet që të jetë prioritet i ditës për ç' do qytetar, grup qytetarësh, parti apo subjekte politike, pasi Shqipëria në 25 vite "Demokraci" ka njohur një Zhvillim të Paqëndrueshëm³³, sidomos në fushën e mjedisit ku pasojat kanë filluar të ndihen tashmë në shëndetin e njeriut ku sëmundjet kancerogjene janë dhjetëfishuar në këto njëzet e pesë vite, dhe ku jetëgjatësia mesatare³⁴ në Shqipëri është me e ulëta në rajon. Kjo periudhë karakterizohet më shumë nga një nevojë egzistencialiteti e hapësirave të gjelbërta, përdorimin dhe menaxhimin e integruar të burimeve ujore në veçanti, dhe komponenteve të tjerë që lidhen më mjedisin fizik dhe social në funksion të shëndetit dhe një jete më të mirë për qytetarin. Shqipëria duke pasur një tranzicion të zgjatur të konsolidimit të shtetit të së drejtës dhe shtetit ligjor ka problematika në mënyrën se si janë bërë normat juridike, apo aktet nënligjore që dalin për zbatim të tyre. Kur flasim për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në Shqipëri, i referohemi ligjit me të njëjtin emër si më sipër. A është ky ligj në Interesit Publik, dhe a bie në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në frymë dhe në gërmë? A është në përputhje me Direktivën e BE³⁵ dhe politikat e saj në kuadrin e anëtarësimit të Shqipërisë³⁶? Ligji 111/2012, për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, " në nenin 39 pika 4 e tij thuhet:

"Pavarësisht nga sasia e rrjedhjes ekologjike që përcaktohet në planet e menaxhimit të baseneve, ajo nuk mund të jetë më e vogël se prurja me qëndrueshmëri 355 ditë në vit (Q355) pika 4 e nenit 39 e Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore: Ndërkohë që më sipër në pikat 3 përcakton se Këshilli Basenit përcakton sasinë e shfrytëzimit të ujit në bazë të nevojave, neni 2 përcakton se duhet të lejohet Rrjedha Minimale Ekologjike pavarësisht autorizimit, pra pavarësisht se si e ka lidhur kontratën subjekti apo se si Këshilli Basenit³⁷ e ka autorizuar. Pika 4 e nenit 39 të ligjit Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, është shteruese si pikë në kuptimin e nenit 39 të ligjit, e cila bie ndesh drejtpërsëdrejti me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë ku në nenin 59 dhe germa "dh" e saj shprehet:

Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private synon: germa "dh" shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm; por edhe Standardet e Bashkimit Europian, dhe me konceptin e Zhvillimit të Qëndrueshëm, pasi zhbën pikën 3 dhe 2, dukë u shprehur se:

Pavarësisht nga sasia e rrjedhjes ekologjike që përcaktohet në planet e menaxhimit të baseneve, ajo nuk mund të jetë më e vogël se prurja me qëndrueshmëri 355 ditë në vit (Q355) pika 4 e nenit 39 e Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, nënkupton faktin se koncesionari në ushtrimin e veprimtarisë së tij, në shfrytëzimin e burimeve ujore i lind e drejta që të shfrytëzojë në maksimumin e tij rrjedhën ujore të lumenjve, apo burimeve të tjera ujore në funksion të veprimtarisë së tij për 355 ditë më përjashtim të 10 ditëve ku legjislatori ka lënë të kuptohet periudhat e thatësirës, pasi matja e prurjeve të sasisë ujore për m³ kub, bëhet një herë në vit, dhe për çdo vit merret si referencë viti paraardhës. Çfarë do të thotë kjo së nëse kemi 100 litra = 100% sasi ujë në Lumin Drin, Vjosë, Bunë, Osum etj, si prurje ujore mesatare vjetore, kjo matje

Konventa Ramsar 1971

Direktiva e BE 2009/177/EC

³¹ Ministria e Mjedisit, Pyjeve, dhe Administrimit të Ujrave. Akt Refuzimi, prot 6352 datë 04.10.2011 Zv Ministri z Arben Demeti. Leksion I Hapur, në UT me temë, ndërtime nën diga, përdorimi i integruar i ujrave, dhe 3E, ekonomicitet,efikasitetit,eficenca, (dep Gazetarisë), Citim I prof Sazan GURIT, Prof Ervin GOCI, Phd Artan MANUSHAQE, datë 19.03.2015, S 311

³³ Arjan Gjonça, Martin Bobak: "Albanian Paradox; Another Example of Protective Effect of Mediterranean Lifestyle?" - The Lancet, vol. 350, 1997.

OBSH përdor teknika të veçanta për demografinë për të vlerësuar statistikat jetike të vendeve ku regjistrimet e lindjeve dhe vdekjeve dihet se janë të paplota. Për më shumë, Health For All database, 2005.

Kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 Tetor 2000

http://ec.europa.eu/dgs/environment/index_en.htm

Ligji për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore 111/2012

bazohet mbi çdo ditë, mbi çdo javë, muaj dhe stinë të vitit, që nënkupton se sasia e prurjeve nuk janë të njëjta për periudha të ndryshme dhe të njëjta njëkohësisht. Pra në kohë thatësire, për bujqësinë apo për rrjedhën ekologjike minimale të lumenjve, priskave apo burimeve të tjera ujore prioritet ligji i jep koncesionarit, ndërkohë që prurjet janë më të mëdha në dimër dhe më pak në behar, në dimër shfrytëzohen maksimalisht nga koncesionari pa u taksuar fare nga shteti, për periudha të thata apo normale kur një tokë bujqësore apo kur një lumë ka nevojë për rrjedhën e vetë ekologjike si edhe lejen mjedisore thuhet : Gjatë operimit të lejohet një sasi uji jo më të vogël se 0.2m³/s (200 l ujë për sek) për funksionimin e ekosistemit³⁸, Langarica nga 8 mijë metro kub ujë në sekondë që ka ky lumë si prurje mesatare koncesionarit i lihet për shfrytëzim nga 5 mije deri në 8 mije m kub për sekond sipas kontratës, VKM 543 datë 01.05.2008 dhe për disa ndryshime në datë 25.04.2009. Edhe ne diskutimet që ka pasur për miratimin e këtij ligji në vitin 2012 nga Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit ka diskutuar në parim edhe rishikimin e ligjit brenda një periudhe maksimale 15³⁹ vjeçare sipas përcaktimeve të direktivës për ujin, 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, dhe qëllimi ka qenë për të mos u abuzuar me këtë ligj, apo pika të cilat cenojnë përdorimin e Integruar të Burimeve Ujore si pjesë e Zhvillimit të Qëndrueshëm të vendit dhe si anëtarë i ardhshëm i Komunitetit të Bashkimit Evropian. Rëndësia e zhvillimit të qëndrueshëm është dhënë më së miri në përkufizimin e të ashtuquajturit Komisioni Brundtland⁴⁰: Zhvillim i qëndrueshëm është ai zhvillim, që plotëson nevojat e së tashmes, pa vënë në rrezik mundësitë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre.“ Për këtë duhen sjellë në harmoni tre dimensionet e zhvillimit: ekonomia, shoqëria dhe mjedisi. Pra zhvillimi ekonomik i një shoqërie nuk duhet të deklarohet si qëllimi i vetëm. Kjo do të kishte pastaj kostot e veta në burimet natyrore apo në drejtësinë shoqërore. Ai është sa kulturor, edhe edukativo – social.⁴¹ Për sa më sipër neni 39 pika 4 e ligjit 111/2012 për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore ku thuhet: Pavarësisht nga sasia e rrjedhjes ekologjike që përcaktohet në planet e menaxhimit të baseneve, ajo nuk mund të jetë më e vogël se prurja me qëndrueshmëri 355 ditë në vit (Q355), kjo pikë bie ndeshë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 59 germa dh e saj

4-2 Rekomandime

Duhet të vendoset një moratorium 5 vjeçar për sa i përket dhënies së lejeve për ushtrim në fushën e shfrytëzimit të ujërave, specifikisht për HEC-et:

duhet të revokohen lejet dhe të bllokohen veprimtaritë që janë në kundërshtim me legjislacionin vendas dhe ndërkombëtar

duhet të pezullohen rreth 300 leje që janë dhënë që nga 2008 e deri më tani, që janë në pritje të fillimit ushtrimit të këtij aktiviteti, për t'u mbrojtur përdorimi i ujit, i mjedisit dhe i shëndetit tonë

të rishikohet dhe mendohet neni 39 dhe pika 4 e ligji nr. 111/2012 për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore si antikushtetues, si një nen që krijon hapësira ligjore të cilat shfrytëzojnë burimet ujore në maksimum, dhe dëmtojnë rrjedhën ekologjike të lumenjve, dhe vaditjen e tokave apo elementeve të tjerë që i nevojiten dhe që kanë lidhje me mjedisin dhe shëndetin tone, pasi bie ndesh edhe me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Bibliografia

Burime parësore

Kushtetuta

Konventa e Esposit 1997, për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekstin ndërkufitar

Konventa e Helsinkit 1992, për menaxhimin e integruar të burimeve ujore

Konventa Ramsar 1971 për mbrojtjen e ligatinave

Konventa Afrikane për Konservimin e Natyrës dhe Burimeve Natyrore (1968) në Algjeri.

Konventa e AARHUS-it, (Danimark 1998) Ratifikuar nga Shteti Shqiptar në vitin 2001, për të drejtën e informimit, pjesëmarrjes, dhe ngritjes së padisë për Publikun në veprimtaritë mjedisore

Samiti OKB, Johannesburg 2002

Rezoluta e Dhjetorit 2002 e UNESCO-s

Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 Tetor 2000

Direktiva e BE 2009/177/EC Direktiva e BE no.409/70 mbi konservimin e zogjve të Egër

Kodë Civil

Ligji për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore 111/2012

KËRKESË Lënda: Për anulimin e punimeve të zbatimit për HEC-in në Lumin e Lengaricës, Përmet. Tiranë, më 21.10.2014

Modeli Gjeodinamik dhe strukturorë, I gjeokonstruksionit. Fier, Dhjetor 2002. Studim tërësor, UPA, Fier,2002. Autor : Prof.

Sazan Guri, Andrea Toska (Ministria e Industrisë dhe Energjitikës

Arjan Gjonça, Martin Bobak: “Albanian Paradox; Another Example of Protective Effect of Mediterranean Lifestyle?” - The Lancet,

Leje Mjedisore, nr 318, dt 17.01.2012

PROCESVERBAL(Diskutim), Komisioni Veprimtarë Prodhuese Tregëtisë dhe Mjedisit Datë 09.10.2012, ora 11:00, Projekt ligji, për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore

Samiti OKB,Johanesburg 2002

Rezolutës së Dhjetorit 2002, UNESCO

vol. 350, 1997. Drejtuar: Presidentit të Republikës, Kryeministrit të Republikës Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Bankës Botërore, Komisioneve Parlamentare, nga ZQMM (Zyra qytetare Mbrojtjes së Mjedisit)

Ligji për të drejtën e informimit, nr.8503, date 30.6.1999

Vendimi i KRRTRSH nr. 06, datë 04.07.2013

Leje Mjedisore Tiranë, më 17.01.2012

Leje Zhvillimore Komplekse të Hidrocentralit Lengarica/1/2, e lëshuar më datë 20.02.2014

LIGJ Nr.9048, date 7.4.2003 për trashëgimin kulturore

Ministria e Mjedisit, Pyjeve, dhe Administrimit të Ujërave. Akt Refuzimi, prot 6352 datë 04.10.2011 Zv. Ministri z Arben Demeti

Burime dytësore

PROCESVERBAL(Diskutim), Komisioni Veprimtarisë Prodhuese Tregtisë dhe Mjedisit

Datë 09.10.2012, ora 11:00, Projekt ligji, për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore

Leksion I Hapur, në UT me temë, ndërtimet nën diga, përdorimi i integruar I ujërave, dhe 3E, ekonomicitet,efikasitetit, eficaenca, (dep Gazetarisë), Citim i prof.. Sazan GURIT, Prof. Ervin GOCI, Phd Artan MANUSHAQE, datë 19.03.2015, S 311 PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL

PËR GAZSJELLËSIN TRANS ADRIATIK Faqe 52 nga147 Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, Diskutim Datë 04.03.2014, ora 11:00 Fq, 9.10,11.12. Besnik Baraj, diskutim, Shkëlzen Kërluku (përfaqësues i koncesionarit HEC- Lengarica)

Burime Interneti

http://ec.europa.eu/dgs/environment/index_en.htm

http://sq.ēikipedia.org/ēiki/Trans_Adriatic_Pipeline

<http://ēēē.tap-ag.com/the-pipeline/route-map>

www.mete.gov.al

<http://www.reporter.al/hidrocentrali-financuar-nga-banka-boterore-kercenon-kanionin-e-lengarices>

PËRGJEGJËSIA E SHTETIT PËR DËMIN NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

ARTAN QERKINI

Avokat, PhD Candidate (UET)

ABSTRAKT

Në këtë punim bëhet fjalë për përgjegjësinë e shtetit për dëmin material dhe jo material të shkaktuar nga puna e parregullt dhe e kundërligjshme të organeve shtetërore, si edhe për përgjegjësitë tjera që ka shteti ndaj qytetarëve të vet. Gjatë ushtrimit të aktivitetit të përditshëm organet shtetërore me veprimet apo mosveprimet e tyre mund të ju shkaktojnë dëme personave fizik dhe personave juridik. Po ashtu shteti duhet të mbahet përgjegjës edhe për dëmin që pësojnë qytetarët nga veprimet terroriste apo demonstratat publike. Shtetet moderne janë të vetëdijshme për rrezikun që ju kanoset subjekteve të së drejtës dhe për këtë arsye me dispozita ligjore përcaktojnë kushtet të cilat duhet të plotësohen në mënyrë që këto subjekte të realizojnë të drejtën e dëmshpërblimit. Në Republikën e Kosovës ekzistojnë dispozita ligjore kundërrthënëse në lidhje me përgjegjësinë e shtetit për dëmin. Këtë çështje në mënyrë të ndryshme e rregullojnë Ligji për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës dhe Ligji për Menaxhimin e Financave Publike. Në punim do të prezantohen hollësisht kontradiktat në mes të këtyre ligjeve. Në punim po ashtu do të prezantohen qëndrimet e teorisë dhe praktikës gjyqësore komparative në lidhje me këtë problematikë.

Fjalë kyç: *Dëmi, përgjegjësia për dëmin, shteti, dëmshpërblimi.*

1. Hyrje

Përgjegjësia e shtetit për dëmin të cilin e shkaktojnë organet shtetërore apo zyrtarët e shtetit ndaj subjekteve juridike ka filluar të paraqitet në versionin e saj modern në shekullin e XIX.

Shteti si tërësi ushtron funksionet, i realizon të drejtat dhe i përmbush detyrat e tij nëpërmjet organeve të veta të përcaktuara në Kushtetutë, si dhe në akte të tjera juridike të nxjerra në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës e të ligjit.

Duke marrë parasysh pozitën superiore të shtetit ndaj subjekteve të tjera të së drejtës, përfshirë këtu edhe të huajt që ndodhen në territorin e tij, përgjegjësia e shtetit për dëmin eventuale i cili mund të shkaktohet nga puna e kundërligjshme dhe e parregullt e organeve shtetërore kërkojnë një trajtim të posaçëm teorik dhe praktik.

Republika e Kosovës garanton të gjitha subjektet e së drejtës (personat juridik dhe personat fizik) se në rast të punës së kundërligjshme dhe të parregullt të organeve shtetërore, atyre do të j'u takojë e drejta për shpërblimin e dëmit.

Këtë e garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji për Administratën Shtetërore, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, e pjesërisht edhe Ligji për Menaxhimin e Financave Publike.

Neni 32 i Kushtetutës së Kosovës "Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 13 i Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (në vijim : LASH), sipas të cilit "Republika e Kosovës është përgjegjëse për dëmin që organi i administratës shtetërore e shkakton me punën e tij të paligjshme ose të parregullt".

Përgjegjësia e shtetit rregullohet edhe me dispozitat e nenit 161 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim : LMD), sipas të cilit "Shteti ose personi që është dashur të parandalojë këtë sipas dispozitave në fuqi, është përgjegjës për dëmin e shkakuar nga vdekja ose lëndimi fizik si rezultat i akteve të terrorizmit ose gjatë demonstratave dhe manifestimeve publike".

Po ashtu në hyrje të këtij punimi vlen të potencohet edhe neni 69 i Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike (në vijim: LMFP), sipas të cilit "Gjykata kompetente është e autorizuar që ta urdhërojë një autoritet publik ose organizatë buxhetore që të paguajë kompensim monetar vetëm për dëme të drejtpërdrejta ekonomike të cilat janë vërtetuar nga gjykata në bazë të provave".

Pra, siç edhe mund të vërehet LMFP është në kundërshtim të hapur me dispozitat e cekura më lartë të Kushtetutës së Kosovës, LASH dhe LMD.

Një çështje tjetër po ashtu me interes teoriko-praktik është edhe natyra juridike e përgjegjësive së organeve shtetërore. Nuk ekziston një unitet i teorisë dhe praktikës gjyqësore për natyrën juridike të kësaj përgjegjësie, përkatësisht nuk ka unitet në lidhje me atë se përgjegjësia e shtetit a duhet të jetë sipas fajësisë, apo duhet të jetë objektive (pavarësisht nga fajti).

Përgjegjësia e shtetit për punën e kundërligjshme dhe të parregullt të organeve shtetërore

Siç u tha edhe në hyrje të këtij punimi, nëpërmjet nenit 13 të LASH, Republika e Kosovës garanton të drejtën e dëmshpërblimit për të gjithë ata të cilët pësojnë ndonjë dëm nga puna e kundërligjshme dhe e parregullt e organeve shtetërore.

Fillimisht imponohet nevoja e dallimit në mes të punës së parregullt dhe të kundërligjshme të organeve të administratës shtetërore.

Përderisa puna e kundërligjshme e organit shtetëror është më e lehtë për t'u definuar, vështirësitë paraqiten me rastin e definimit të punës së parregullt të këtyre organeve.

Veprime të kundërligjshme të organit të administratës shtetërore, konsiderohen të gjitha ato veprime të cilat bien ndeshë me ligjin. Kështu p.sh. nëse organi shtetëror në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimet Private në Shëndetësi refuzon licencimin e ndonjë Spitali privat dhe me atë rast për subjektin kërkuar shkaktohet ndonjë dëm material apo jo material, krijohet e drejta e Spitalit privat që të kërkojë kompensimin e dëmit material dhe jo material. Veprim të kundërligjshëm të organit të administratës shtetërore paraqet edhe moszbatimi i kontratave të prokurimit publik nga ana e organit shtetëror edhe pse me këtë rast nuk po shkelet ligji por kontrata. Por, nëse merret parasysh fakti se kontrata është ligj për palët, atëherë mos përmbushja e obligimeve kontraktuale nga njëra palë, në këtë rast nga shteti, paraqet shkelje ligjore e cila ngarkon shtetin me përgjegjësinë për dëmin që mund ta pësojë pala tjetër nga mos përmbushja e rregullt e kontratës.

Sa i përket llojit të përgjegjësive, mendoj se përgjegjësia e Republikës së Kosovës për dëmin e shkakuar nga organi shtetëror duhet të vije në shprehje vetëm në qoftë se ky organ vepron në kundërshtim me ligjin, me dashje apo nga pakujdesia e rëndë. Ky qëndrim ka dominuar edhe në praktikën gjyqësore të ish Jugosllavisë. Kuptimin e këtij qëndrimi duhet ta kërkojmë në tendencën që të nënvizohet se nuk do të ekzistojë përgjegjësia e shtetit për dëmin në qoftë se deri te zbatimi i gabuar i të drejtës materiale kemi ardhur për shkak të interpretimit të gabuar të ligjit nga ana e organit shtetëror. Kjo praktikë e krijuar nga gjykatat e rregullta ka marrë parasysh sjelljen subjektive të personit zyrtarë në rastin e zbatimit të dispozitave ligjore dhe nënligjore, me ç'rast për përcaktimin e përgjegjësive së organit shtetëror me rëndësi ka qenë të përcaktohet se a bëhet fjalë për ligjin i cili është i qartë, përkatësisht a kemi të bëjmë me ndonjë ligj i cili është i qartë dhe preciz dhe që në teori dhe praktik të mos ketë dilema në zbatimin e tij, apo kemi të bëjmë me ligje dhe dispozita të paqarta, apo edhe me zbrazëtira juridike. Në rast

Borkovic Ivo, Upravno Pravo, peto izdanje, Informator Zagreb, 1995, fq. 117.

Gjata Rustem, Detyrimet Jashtëkontraktore, Muza Tiranë, 2010, fq. 128.

se personi zyrtarë duhej zbatuar një dispozitë të qartë ligjore, ndërsa ai me qëllim apo nga pakujdesia e rendë e kishte zbatuar ligjin jo në mënyrë të duhur me ç'rast për palën në procedure ishte shkaktuar dëm, në atë rast shteti do të mbajë përgjegjësinë për kompensimin e demit, në të kundërt përgjegjësia për dëmin nuk do të binte mbi shtetin.

Me punë të parregullt të organeve shtetërore kemi të bëjmë atëherë kur organet shtetërore gjatë punës së tyre nuk shkelin ligjin, por punës i qasen me neglizhencë duke mos përfillur interesat e qytetarëve të cilët ju drejtohen organeve shtetërore. Zakonisht me punë të parregullt nënkuptojmë shkeljen e procedurave të brendshme të punëdhënësit (organit shtetëror). Edhe në këto raste ligji parasheh përgjegjësinë e shtetit për kompensimin e demit.

Në Kosovën e paraluftës ka pasur një praktikë gjyqësore mjaftë të zhvilluar në lidhje me përgjegjësinë e shtetit (në atë kohë bashkësive shoqërore politike dhe Komunave) për dëmin e shkaktuar nga puna e kundërligjshme dhe e parregullt e organeve shtetërore.

Në vijim do të citojmë disa sentence nga praktika gjyqësore kosovare :

“ Personi juridik mbahet përgjegjës për veprimet e palejuara të organeve të veta edhe atëherë kur këto veprime nuk janë kryer në kuadrin e veprimtarisë së personit juridik të përcaktuar me Statut. Për përgjegjësinë deliktore të personit juridik nga neni 172 i LMD-së, fakt vendimtarë është që dëmtuesi të ketë vepruar në funksionin e organit të personit juridik”³.

“ Gjatë ekzekutimit të Aktvendimit për rrënimin e objektit nuk janë respektuar rregullat e profesionit të ndërtimtarisë për rrënimin e objekteve, dhe për këtë shkak ka ardhur deri te dëmtimi i pjesëve të ndërtesës të cilat me lehtësi kanë mund të hiqen, siç janë dyert, dritaret, ulluqet etj. Gjatë ekzekutimit të vendimeve administrative, organi ekzekutues është i obliguar që aktin ta ekzekutojë në atë mënyrë që me veprimet konkrete të shmangen ato veprime që mund të shkaktojnë dëme të panevojshme. Ndërsa në rastin konkret nuk është vepruar në këtë mënyrë”⁴.

Në aspektin komparativ vlen të potencohet një qëndrim interesant i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë, sipas të cilit përgjegjësia e shtetit për punën e kundërligjshme apo të parregullt të organeve shtetërore duhet të jetë objektive, për dallim prej gjykatave të rregullta të cilat në raste të tilla kanë mbajtur qëndrimin se përgjegjësia duhet të jetë e karakterit subjektiv.

“Për ekzistimin e përgjegjësive juridiko-publike të shtetit për dëmin në kuptim të nenit 13 të Ligjit për administratën

shtetërore, në rastin konkret duhet që në mënyrë komulative të përmbushen kushtet si në vijim :

Puna e kundërligjshme ose e parregullt e organit shtetëror (në rastin konkret Ministrisë së Financave të Republikës së Kroacisë);

Ekzistimi i demit i cili i është shkaktuar parashtruesve të kërkesës kushtetuese ;

Ekzistimi i lidhjes kauzale në mes veprimit të kundërligjshmen ose të parregullt dhe demit të shkaktuar. Në këtë rast

është e rëndësishme që të provohet se dëmi i pësuar është pasojë e drejtpërdrejt e veprimit të kundërligjshëm apo të parregullt të organit shtetëror, çka do të thotë se dëmi nuk do të shkaktohej pa këtë veprim “⁵.

Ky qëndrim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë përbën një kthesë në formë të shkronjës (U) në lidhje me natyrën juridike të përgjegjësive së shtetit për punën e kundërligjshme apo të parregullt të organeve të administratës shtetërore. Ky vendim promovon përgjegjësinë objektive të shtetit për dëmin që shkaktohet nga zbatimi jo i duhur i ligjeve apo akteve nënligjore nga organet shtetërore.

3. Përgjegjësia e shtetit për aktet terroriste

Nëpërmjet LMD-së, shteti pranon përgjegjësinë për dëmin të cilin mund ta pësojnë subjektet juridike, nga aktet terroriste dhe demonstratave apo manifestimeve publike. Siç edhe mund të vërehet në këtë rast shteti përveç përgjegjësive për punën e kundërligjshme dhe jo të rregullt të organeve shtetërore po e merr përgjegjësinë edhe për aktet terroriste dhe manifestimet publike të cilat ndodhin në territorin e Republikës së Kosovës. Në bazë të LMD të vitit 1978 përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga aktet terroriste dhe demonstratat e kishin të ashtuquajturat bashkësitë shoqërore politike të asaj kohe.

Shtrohet pyetja se cilat janë ato veprime të cilat mund të definoohen si terroriste, e për të cilat duhet të ekzistojë përgjegjësia e shtetit për kompensimin e demit.

Aktet terroriste mund të definoohen si në vijim:

Ushtrimi i dhunës dhe veprimeve tjera të cilat mund të konsiderohen të vrazhda dhe të papërfillshme për jetën dhe integritetin trupor të njeriut, me qëllim të shkaktimit të frikës dhe ndjenjës së pasigurisë të qytetarët ;

Aktet e dhunës me qëllime të qarta politike;

Veprimet e dhunshme të grupeve të organizuara terroriste etj.⁶

Sa i përket demonstratave publike ato mund të definoohen si shprehje e pakënaqësisë në vende publike me gjendjen ekonomike, sociale, politike etj.

Gjykata Supreme e Kosovës, Aktgjykimi GZ. 409/79.

Gjykata Supreme e Kosovës, Aktgjykimi GZ. 409/79.

Ivica Cernic, Odgovornost drzave za stetiu, Novi Informator, 2010, Zagreb, fq. 30.

Ivica Cernic, Odgovornost drzave za stetiu, Novi Informator, 2010, Zagreb, fq. 181.

Përgjegjësia e shtetit për dëmin nga aktet terroriste është shprehje e sigurisë juridike të cilën shtetet demokratike e ofrojnë për qytetarët e tyre.

Përgjegjësia e shtetit në këtë rast është e natyrës objektive, sepse nuk kërkohet që organet shtetërore të jenë fajtores, përkatësisht nuk kërkohet që aktet terroriste të kenë ardhur për shkak të neglizhencës së organeve shtetërore të sigurisë, mjafton që aktet terroriste apo demonstratat publike të kenë ndodhur dhe nga aktet e tilla subjektet juridike të pësojnë dëm.

Raste nga praktika gjyqësore komparative :

“ E paditura Republika Federative e Jugosllavisë është e obliguar që paditësit të ja kompensojë dëmin e shkaktuar nga veprimet terroriste, në kuptim të nenit 180 të LMD-së. Kjo për arsye se organet e të paditurës kanë qenë të obliguara t'i pengojnë aktet terroriste, pa marrë parasysh faktin se a janë këtë organe fajtores për aktet e tilla”⁷.

“ Për ekzistimin e aktit terrorist nuk duhet domosdo që akti të ndërmerret për qëllime politike, por mjafton që një veprim tillë të bëhet me qëllim të shkakimit të frikës dhe krijimit të ndjenjës së pasigurisë tek qytetarët”⁸.

Neni 69 i Ligjit për Menagjimin e Financave Publike dhe kompensimi i dëmit jomaterial nga ana e shtetit

LMFP përcakton natyrën e demit për të cilat autoritetet publike mund të urdhërohen të kompensojnë Paditësit. Neni 69 i LMFP –së thekson:

“Gjykata kompetente është e autorizuar që të urdhërojë një autoritet publik ose organizatë buxhetore që të paguajë kompensim monetar vetëm për dëme të drejtpërdrejta ekonomike të cilat janë vërtetuar nga gjykata në bazë të provave”⁹.

Ky qëndrim i ligjvënësit kosovar është në kundërshtim të hapur me Kushtetutën e Kosovës dhe Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, sepse obligon shtetin të kompensojë vetëm dëmin material por jo edhe atë jo material.

Në bazë të nenit 13 të KEDNJ-së shteti i Kosovës është i obliguar të ofrojë kompensim për paditësit. GJEDNJ ka gjetur se e drejta në kompensim është pjesë e të drejtës për mjete efektive juridike. Në rastin Z. dhe të tjerët kundër Mbretëria e Bashkuar GJEDNJ ka vendosur se në rastet kur kemi të bëjmë me shkelje të së drejtës për jetë, si një prej të drejtave më fundamentale, kompensimi për dëmet joekonomike duhet të konsiderohet si pjesë e mjeteve juridike në dispozicion¹⁰.

Shteti, përkatësisht Republika e Kosovës është ligjërisht e obliguar të kompensojë viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut sipas neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës në rastet kur autoritetet publike janë përgjegjëse për shkeljen e të drejtave të njeriut. Ky obligim rrjedhë nga Kushtetuta e Kosovës, prandaj, çdo ligj që shprehimisht ose në çfarëdo mënyre tjetër nuk e obligon shtetin apo autoritetet publike që të kompensojnë dëmin qoftë të natyrës materiale ose jo-materiale është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës.

LMFP është në kundërshtim me nenin 13 të KEDNJ-së, ngase nuk i mundëson Paditësit që të ketë qasje në mjete efektive juridike për të realizuar të drejtat e tyre për kompensim të dëmit jo-material në rastet kur autoritetet publike janë përgjegjëse për shkeljen e të drejtave të njeriut. Për më tutje, kjo dispozitë e LMFP-së tenton që të përjashtojë shtetin nga përgjegjësia për veprimet që shteti ka identifikuar si problematike kur kryhen në raport me qytetarët si palë private. Tutje, kjo dispozitë ka tendencë që të jetë diskriminuese, ngase nuk lejon të dëmtuarit, por edhe të gjithë qytetarët e Kosovës që të kërkojnë kompensim për shkeljen e të drejtave të njeriut nga autoritetet publike, ndërsa në anën tjetër, një rregull e njëjtë, përkatësisht një përjashtim i njëjtë nuk vlen në raport me shkeljen e të drejtave të njeriut nga palë private për të cilat ligji lejon që të kompensohen edhe për dëme jo-materiale.

LMFP në nenin 70, duke iu referuar pjesës e cila përfshinë procedurat gjyqësore dhe të arbitrazhit më tutje thekson se: Kjo Pjesë do të mbisundojë mbi të gjitha dispozitat kundërtënëse në një ligj tjetër apo Rregullore të UNMIK-ut, përveç nëse ai ligj apo rregullore shprehimisht përcakton se ato dispozita kundërtënëse do të mbisundojnë mbi një apo më shumë dispozita të kësaj Pjesë¹¹. Në këtë mënyrë, ky ligj eliminon të gjitha dispozitat tjera ligjore nëpër ligjet tjera, duke përfshirë edhe dispozitat e LMD-së, përmes të cilave Paditësit kanë mundësi të realizojnë të drejtën e tyre për mjete efektive juridike për të kërkuar kompensimin e dëmit jo-material të shkaktuara si pasojë e veprimeve të paligjshme e rrjedhimisht përgjegjësisë ligjore nga shteti. Neni 69, prandaj, është në kundërshtim me nenin 13 të KEDNJ-së dhe në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, gjegjësisht nenit 32 dhe 54 të saj.

Konkluzione

Përgjegjësia e shtetit për dëmin ndaj subjekteve juridike që gjenden në territorin e tij mund të ketë karakter subjektiv e po ashtu edhe karakter objektiv.

Simonovic Draboljub, Naknada stete, Sluzbeni Glasnik, 2009, Beograd, fq. 207.

Ivica Cernic, Odgovornost drzave za stetiu, Novi Informator, 2010, Zagreb, fq. 182.

Lihji nr. 03/L-048 për Menagjimin e Financave Publike të Republikës së Kosovës, neni 69, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë : Viti III / Nr. 27/3 qershor 2008.

Në bazë të nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës, gjykatat kosovare janë të obliguara që të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë t'i interpretojnë në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 70 LMFP.

Sa heqë që subjektet juridike pësojnë dëm nga puna e kundërligjshme apo e parregullt e organeve shtetërore, për përgjegjësinë e shtetit në raste të këtilla duhet që dëmi të jetë shkaktuar me dashje apo nga pakujdesia e rendë, ndërsa nëse dëmi është shkaktuar pa qëllim dhe nga pakujdesia e lehtë shteti nuk do të mbahet përgjegjës.

Situata është krejtësisht ndryshe nëse subjektet juridike pësojnë dëm si pasojë e akteve terroriste. Në ato raste përgjegjësia e shtetit është e natyrës objektive, e kjo do të thotë se nuk merret parasysh fakti nëse organet shtetërore kanë qenë apo jo fajtores për aktet terroriste që kanë shkaktuar dëmin.

Përfundimisht, nga gjithçka u tha më lartë, LMFP, përkatësisht neni 69 është kundër-kushtetues. Neni në fjalë urgjentisht duhet t'i hiqet nga ligji, qoftë me amandatin e tij, qoftë përmes Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, të shpallet si në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe në këtë mënyrë të eliminohet nga rendi juridik i Kosovës.

FORMAT E MANIFESTIMIT TË KRIMIT TË ORGANIZUAR

BESIM ARIFI

PhD candidate, European University of Tirana, Tiranë

e-mail:besiarifi@hotmail.com

ABSTRAKT

Krimi i organizuar cilësohet me disa veçori, siç janë; lidhja e disa personave ne mes veti për qëllim të kryerjes së aktivitetit kriminal. Gjate kryerjes së këtij aktiviteti kriminal pa tjetër duhet të ekzistoj një strukture organizative me hierarki dhe pushtet të fuqishëm të udhëheqësit të grupit si dhe të ketë dominim të rregullit, rendit, disiplinës, përgjegjësisë së anëtareve të grupit, ruajtja e fshehtësisë së veprimit dhe mos zbulimi i organizatës etj. Çdo devijim nga këto kërkesa të grupit sanksionohet me dënime të ashpra deri në likuidim fizik. Kryerja e veprimeve kriminale nga këto grupe ose nga anëtarët e tyre, behet me kujdes dhe me një plan dhe ato detyra pastaj u ndahen anëtareve të grupit. Përpilimi i këtyre planeve e pastaj realizimi i tyre në praktike behet zakonisht me ane të kërcënimeve të ndryshme, shantazhit, dhënies së mitos, shfrytëzimi i lidhjeve me policinë, prokurorinë dhe gjyqësorin dhe organizatat tjera. Veprimet e këtyre grupeve kriminale mund ta kalojnë edhe kufirin shtetëror, të kenë shtrirje me të gjere dhe në këtë mënyrë të dalin në rrafshin ndërkombëtar.

Këto grupe, shoqata dhe organizata, regjistrohen vetëm sa për sy e faqe, për të pasur mbulese para organeve të pushtetit. Ndërsa aktiviteti i tyre i vërtete është marrja me veprime kriminale. Këto grupe dhe shoqata kriminale, në disa raste nuk e fshehin përcaktimin e tyre kriminal dhe terrorist. Ato përdorin dhunën, vrasjet, shtrëngimin, korrupsionin, terrorin dhe frikësimin për të realizuar qëllimet e veta. Grupet dhe shoqatat e tilla, veprimin e tyre e arsyetojnë me aktivitete gjoja të natyrës politike, veprimtari për të drejtat dhe liritë e grupeve të caktuara kulturore, etnike etj.

Ndër format më të shprehura të krimit të organizuar në Kosovë, pa mëdyshje se janë narko-kriminaliteti (në trajtën e vetme të shpeshtë të kontrabandimit me narkotikë) dhe trafikimi me qenie njerëzore (në trajtën e trafikimit të femrave) me qëllim të detyrimit në prostitucion. Edhe raportet e ndryshme regjionale dhe ndërkombëtare mbi Kosovën veçojnë këto dy forma të krimit të organizuar si më fitimprurëse të biznesit të kundërligjshëm kriminal.

Fjalë kyç: *krimi i organizuar, grupet kriminale, ligjet, kodi penal*

Krimi preokupim i madh i njerëzimit

Krimi si fenomen shoqëror dhe individual dhe shkaqet e tij, kanë qenë përherë objekt interesim i shoqërisë njerëzore. Interesimi dhe preokupimi i njerëzimit për krimin shpjegohet me ndikimin e disa faktorëve: Faktorët subjektiv dhe emocionalë.

Faktorët objektiv, ku bëjnë pjesë:

Faktorët ekonomikë e material

Interesimi me qëllim të vetëmbrojtjes dhe mbrojtjes.

Teoritë mbi kriminalitetin dhe shkaqet e tij

Kriminalitetit si dukuri e rrezikshme qysh nga kohet e hershme ka zgjuar interesim dhe janë bërë përpjekje që të shpjegohen shkaqet dhe natyrën e tij. Meqenëse natyra e këtij teksti nuk lejon që të paraqiten në mënyrë të detajuar mendimet dhe pikëpamjet më të hershme mbi kriminalitetin dhe shkaqet e tij, por në pika të shkurtra do të paraqesim disa pikëpamje që kanë disa karakteristika. Historiku mbi kriminalitetin dhe shkaqet e tij do të vështrohen në dy faza:

faza e parë përfshin mendimet e hershme mbi shkaqet e kriminalitetit dhe

faza e dytë përfshin mendimet e shkollave të njohura juridiko – penale.

Mendimi antik mbi kriminalitetin

Lidhur me dukurinë e kriminalitetit, krimit dhe dënimit, ka patur mendime dhe është folur edhe me herë, si p. sh. Në Egjiptin e vjetër, Kinën e vjetër, Babiloninë e vjetër. Idetë e para mbi kriminalitetin dhe shkaqet e tij gjenden në punimet dhe traktatet filozofike të filozofëve greke. Në këto traktate hasen mendime mbi kriminalitetin, shkaqet e tij dhe qëllimin e ndëshkimit, dhe arsyen e marrjes së individit me sjellje kriminale, po ashtu në këto traktate parashihen disa mendime të filozofëve që janë angazhuar dhe kanë bërë përpjekje për eliminimin e dënimeve të vrazhda, barbare, ndaj kryerësve të veprave penale.

Platoni- filozof grek ka dhënë kontribut në trajtimin e çështjes së krimit, veçmas ai ndalet në shkaqet që ndikojnë në kriminalitete. Në veprën e tij “Ligjet” ka trajtuar çështjen e krimit e veçmas te disa veprave penale, vjedhjeve, e vrasjeve, sipas tij krimit kryhet për shkak të ndikimit të instinktit, shpirtit të sëmurë të kryerësit të veprës penale dhe faktorëve të jashtëm janë rezultat i çrregullimeve dhe degjenerimeve anatomiko-biologjike që ndodhin te disa individ. -E për krimet e pa përmirësuar propozon aplikimin e masave preventive të edukimit, përmirësimit, duke e edukuar shpirtin dhe trupit, duhet të aplikohet masave dhunën dhe dhembjen me një ane masat e izolimit nga shoqëria dhe masat të eliminimit fizike nga shoqëria.

Aristoteli -Mendon se individit merret me sjellje kriminale për shkak të motiveve dhe shprehive kriminale, e si shkak përmend skamjen edhe varfërinë. -sipas i tij personat te cilën kryejnë krime janë armiq të shtetit dhe shoqërisë. Për dallimin nga Platoni ai mendon se individit kryen krime për shkak se është në ndikimin e rrethanave ekonomike – sociale.

Krimi i organizuar (kontrabanda, trafikimi, pastrimi i parave etj), korrupsioni janë aktivitete fitimprurëse, të cilat ndikojnë në stabilitetin ekonomik, politik dhe social të çdo vendi. Këto fenomene në vazhdimësi po i përcjellin në një apo formë tjetër, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, që reflekton mungesën e mbrojtjes të drejtave pronësore, të mundësive të punësimit dhe dobësisë së shtetit.

Veçoritë themelore të Fenomenit Kriminal

Kriminalitetit si dukuri e rrezikshme për shoqërinë është manifestuar në forma të ndryshme gjatë periudhave të ndryshme historike. Pra secila periudhë i ka pasur disa karakteristika dhe forma të veçanta të kriminalitetit. Vëllimi dhe struktura e kriminalitetit, ka qenë e lidhur ngushtë me zhvillimin dhe transformimin e shoqërive dhe sistemeve të caktuara shoqërore – ekonomike. Në kohën bashkëkohore ka lëvizje aq të mëdha, dhe këto lëvizje janë si rezultat i ndryshimeve dhe zhvillimeve të hovshëm ekonomike, të industrializimit, urbanizimit, të rrjetit dhe përsosjes së mjeteve të komunikimit, të aplikimit të teknologjisë elektronike dhe kompjuterike. Pra të gjitha këto lëvizje që ndodhin në botën bashkëkohore padysim që në mënyrë të drejtpërdrejt ndikon edhe në paraqitjen e formave të ndryshme të kriminalitetit.

Veçoritë kohore dhe sezonale të kriminalitetit

Gjatë studimeve, hulumtimeve dhe kërkimeve të autorëve, është vërtetuar se paraqitja e kriminalitetit dallohet prej kohës në kohë, vërehen karakteristika të veçanta të kriminalitetit gjatë natës, ditës, sezonës, prej regjionit në regjionin tjetër.

Dr. Ragip Halili, Kriminologjia, UNIVERSITETI AAB, Fakulteti juridik Master Penal
Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Transparency International Kosova (TIK), faqe 6, tetor 2011

Veçoritë regjionale të kriminalitetit

Në literaturën kriminologjike, ekzistojnë mendime se disa forma të kriminalitetit janë të shprehur më shumë në disa regjione. Krimet e prostitucionit, krimet e dhunës, të narkomanisë, janë më të paraqitura në regjione industriale, në metropole, në qendra të mëdha ku është e koncentruar më shumë shoqëria, ndërsa krimet kundër jetës dhe trupit në disa regjione tjera.

Zonat kufitare më shume janë të koncentruar dukuritë e tregtisë dhe kontrabandës me artikulje të ndaluar ose me valute të huaja. Në këtë drejtim shpesh përmenden termi “zona kriminale” ku kriminaliteti është më tepër i pranishëm.

Lokacion tjetër ku kemi përhapjen e kriminalitetit është relacioni fshat – qytet. Kërkimet e shumta kriminologjike, vërtetojnë se paraqitja e kriminalitetit dhe shpërndarja e tij në regjionet fshatare, dallon nga paraqitja dhe shpërndarja e tij në veçoritë e moshës, regjionet e qyteteve dhe qendrave të ndryshme industrial, gjinia dhe kriminaliteti.

Gjatë studimeve, hulumtimeve dhe kërkimeve kriminologjike, është vërtetuar se me sjellje kriminale merren persona të moshave të ndryshme. Moshë e kryerësve të veprave penale ndahet në moshë të rritur dhe të mitur, moshë mitur ndahet në të mitur të rinj 14-16 vjeç dhe mitur të rritur 16-18 vjeç, si moshë e rritur konsiderohet moshë 18 vjeç e deri në vdekje të individit. Në literaturë kriminologjike, theksohet se më tepër që merret me krime është gjinia mashkullore se sa gjinia femërore.

Kriminaliteti i organizuar cilësohet me disa veçori, si lidhshmëria e përhershme me shume persona në kryerjen e aktiviteteve kriminale, struktura organizative me hierarki dhe pushtet të fuqishëm të udhëheqësit, ku dominon rregullia, rendi, disiplina, përgjegjësi, ruajtja e fshehtësisë, mos tradhtia etj.

Quket kriminaliteti i organizuar ngase delikuentet gjatë ndërmarrjes së aktiviteteve kriminale ata i planifikojnë dhe i koordinojnë në mënyrë të veçantë. Ata depërtojnë tek të gjitha portet e pushtetit administrative, ekzekutiv, policor e gjyqësor.

Organizatat më të njohura kriminale në botë janë: “Mafia siciliane”, “Camorra”, “Ndrangheta”, “Koza Nostra”, në SHBA, në Japoni “Yakuza”, në Kinë “Triada”, në Spanjë “Eta”, në Irland “IRA”, Narko kartelet në Amerikën Latine etj.

Disa formate të tjera të kriminalitetit është edhe

Reketizmi - si formë e kriminalitetit të organizuar manifestohet duke organizuar ndërmarrjen në mënyrë të organizuar të kërcënimeve, shantazheve të llojllojshme nga individët dhe grupe kriminale të organizuar ndaj personave që kanë biznese të ndryshme, me qëllim që në dobi të tyre të paguajnë sasi të caktuar të të hollave.

Larja e parave - si formë e kriminalitetit të organizuar kuptojmë, që paratë e fituar nga aktivitetet kriminale të deponohen dhe investohen në punë dhe veprimtari legale, dhe të përdoren si para të pastruara, të lara. Procesi i larjes së parave ndahet në tri faza:

Faza I-rë - përfshinë transferimin fizik të parave të cilat janë fituar si rezultat i veprimtarisë kriminale,

Faza II-të - përfshinë mbulimin duke kyçur në transaksione financiare komplekse për t'i humbur gjurmët dhe rrugët e fitimit të parave.

Faza III-të - përfshinë përpjekjen dhe angazhimin që këto para “të pastruara” të paraqiten si pasuri dhe kapital i tij i pastër.

Kriminaliteti i organizuar ka përfshirë shumë segmente të jetës bashkëkohore dhe për këtë arsye shoqëria bashkëkohore ka kërkesa të shumta për luftimin e kësaj dukuri kriminale, ku çdo ditë i rrezikohen dhe i cenohen vlerat më vitale të njeriut.

Si përpjekje e tillë konsiderohet edhe Konferenca Ndërkombëtare mbi Kriminalitetin e Organizuar e cila u mbajt në Napoli të Italisë, prej datës 21 deri me 24 nëntor 1994.

Për pengimin dhe luftimin e kriminalitetit të organizuar, u krijua një aleancë ndërkombëtare në krye me SHBA-në, me ç’ rast i shpalli hapur luftë terrorizimit ndërkombëtar. Po ashtu edhe shtete kanë ndërmarrë masa të duhura për luftimin dhe pengimin e krimit të organizuar, sidomos në rregullimin ligjor, duke themeluar agjenci të veçanta për luftimin e krimit të organizuar.

Në kodin penal të Republikës së Kosovës në kapitullin e XIII të DOMETHËNIA E SHPREHJEVE NË KODIN PENAL, në nenin 120, pika 13 Përkufizimet, Grupi kriminal është shpjeguar në këtë mënyrë:

Grupi kriminal i organizuar - bashkim i strukturuar, që ekziston për një kohë të caktuar, i tre apo më shumë personave për kryerjen e veprave të caktuara penale, që vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave të rënda penale për përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore.

Se çfarë është gjendja aktuale, dhe me cilat sfida po përballen në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, shumica e vendeve të Ballkanit? Ky punim do të tentojë të ofrojë të dhëna të mjaftueshme dhe shumë të rëndësishme lidhur me legjislacionin dhe praktikën e vendeve të rajonit në luftë kundër krimit të organizuar dhe pasurisë së paligjshme.

Kroaci – Të dhënat nga raportet e ndryshme lidhur me këtë vend, të tilla si “Raporti Kombëtar për Drejtësi dhe Punë të Brendshme i vitit 2004” vëren se “krimi i organizuar në Republikën e Kroacisë kryesisht përcaktohet nga tre faktorë: pozicionin gjeografik, proceset gjithëpërfshirëse ndërkombëtare dhe nga pasoja e shkatërrimit të Jugosllavisë”. Korniza ligjore për frenimin e krimit të organizuar po përmirësohet çdo herë e më shumë dhe institucionet kroate po përmirësojnë kapacitetet e tyre për tu marrë me krimin e organizuar.

Bullgari - Legjislacioni kundër krimit të organizuar dhe pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme, rregullohet në detaje me disa ligje. Këto ligje po zgjerohen dhe përmirësohen vazhdimisht. Kompetencat e institucioneve që i luftojnë këto dukuri negative përcaktohen plotësisht dhe ekziston ndarje e qartë ndërmjet përgjegjësive dhe detyrimeve të tyre. Problemi në këtë

vend është se ligjet nuk zbatohen mjaftueshëm në praktikë. Ka shumë arsye për këtë: mungesa e burimeve financiare dhe të tjera, mungesa e motivimit, numri i vogël i krimeve të zbuluara, etj.

Sllloveni - Përmes analizimit të legjislacionit që ndërlihet me luftimin kundër krimit, analizat kanë treguar që në krahasim me pjesën tjetër të Evropës, shteti sllloven ka ligje më adekuate dhe institucione shumë më të specializuara për ndjekjen penale të krimeve, të cilat megjithatë nuk janë të lidhura me njëra tjetrën dhe nuk punojnë së bashku. Të gjeturat tregojnë që ky bashkëpunim nuk është duke funksionuar mirë për shkak të interesave personale të individëve që punojnë në këto institucione. Gjykatat të cilat së fundmi janë fajësuar për mos-ujtje të shkallës së krimit, nuk kanë përfaqësues politik që mund të flasin në favor të pavarësisë së gjykatave.

Serbi - Krimi i organizuar në këtë shtet është i pranishëm në të dyja format e tij “klasike”, si krim i dhunshëm, kontrabandimi i narkotikëve, vjedhja e makinave, etj, por gjithashtu edhe në formën e “re”, të organizuar si krim i “jakës së bardhë” lidhur me shpërdorimet e privatizimit, shmangia nga tatimet ose shpërdorimi i burimeve publike. Element domethënës që ka ndikim në nivelin e krimit të organizuar është statusi i vendit transit për disa tipe të veprimtarisë kriminale. Faktor tjetër i rëndësishëm është bashkëpunimi rajonal dhe ndër-shtetëror i grupeve të organizuara kriminale.

Që nga viti 2003 dhe vrasja e Kryeministrit Zoran Djindjic, nga një grup i organizuar kriminal, Serbia ka ndërtuar kornizë të fortë ligjore dhe institucionale për ta luftuar krimin e organizuar, që përfshin organet e veçanta të krijuara (prokuroria, gjykatat, njësitë policore), mundësinë për të përdorur teknika të veçanta hetimi me qëllim të luftimit të krimit të organizuar si dhe mundësia e dhënies së statusit të dëshmitarit bashkëpunues anëtarit të grupit të organizuar kriminal.

Maqedoni – Edhe ky shtet përkundër që ka avancuar dukshëm në procesin ligjvënës në luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, megjithatë nuk është imune ndaj aktiviteteve kriminale dhe të jashtëligjshme nga grupet kriminale dhe veprimeve korruptive nga individë dhe zyrtarë publikë.

Shqipëri - Për disa vjet në Shqipëri, reagimi ndaj veprimtarive kriminale në rritje ishte i dobët për shkak të presionit, korrupsionit, frikës dhe pasigurisë. Sidoqoftë, ishte presioni i vazhdueshëm ushtruar nga organizatat ndërkombëtare dhe nga vet qytetarët që i bënë institucionet të ndërmarrin masa për luftimin e krimit të organizuar dhe disa prej formave të tij, si: trafikimi i qenieve njerëzore – femra ose fëmijë, trafikimi i armëve, trafikimi i automjeteve, trafikimi i substancave narkotike dhe kultivimi i bimëve narkotike.

Përfundimi

Duke ditur se krimi i organizuar është një dukuri që shfaqet çdo ditë e me tepër, atëherë kjo mund të thuhet se ky krim duhet të luftohet apo të ndjekë nga organet kompetente dhe organet përgjegjëse që janë të përcaktuara me ligjet në fuqi, por jo vetëm kaq. Kontribut tepër të çmuar mund të ofrojnë edhe grupet e caktuara të interesat siç janë: organizatat e ndryshme civile, popullsia në përgjithësi si dhe mekanizmat tjerë relevantë. Krimi i organizuar me paraqitjen e tij dëmton jo vetëm shtetin por normalisht që dëmton edhe popullsinë e atij shteti duke ditur se e njëjta popullsi paguan kontributet e saja me taksat e tyre dhe në këtë mënyrë apo në mënyrë indirekte nga ky krim preket edhe popullsia. Është e nevojshme pra që organet e ndjekjes në bashkëpunim me strukturat arsimore apo edhe organizatat tjera të këshillojnë dhe ndihmojnë popullsinë lidhur me këtë lloj krimi. Kjo ndihmesë e dhënë për ta jo vetëm që është e nevojshme por, është edhe e dobishme duke pasur parasysh rëndësinë që ka një fushatë e vetëdijesimit rreth kësaj dukurie. Kjo vetëdije mund të ngrihet edhe me organizimin e trajnimeve apo work-shopeve të ndryshme neper organizatat e ndryshme që gjithmonë do të jete një kontribuues shume i mire për vetëdijesimin dhe për ngritjen e vëmendjes që jo vetëm policia, prokuroria dhe gjykata janë ato që e ndjekin këtë lloj të krimit. Këto institucione që u përmenden tani patjetër se detyrë primare e kanë ndjekjen, kapjen dhe dënimin e kryesve të këtyre veprave por, ndikim dhe kontribut të veçantë mund të japin edhe popullsia dhe grupet e ndryshme të interesit.

Në këtë punim kemi paraqitur krimin e organizuar si një dukuri e cila shfaqet pa mëshirshëm në shoqërinë tonë, gjithashtu kemi përmendur edhe formate luftimit të tij si dhe praktiken e disa shteteve që kanë pasur me këtë dukuri shoqërore në rritje e sipër.

Bibliografia

- Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Transparency International Kosova (TIK), tetor 2011
 Gluščić, Stjepan, Mbështetje për promovimin e mirëkuptimit reciprok në mes të vendeve të Bashkimit Evropian dhe Ballkanit
 Perëndimor, Raport nacional, DREJTËSIA DHE PUNËT E BRENDSHME, nën Marrëveshjen
 Grantiti Specifik RELEX I-2 190202 REG 4-14, Cepor, 2004
 Kodi Nr. 04/L-82, Kodi Penal I Kosoves, 20 prill 2012, faqe 53
 Dr. Ragip Halili, Kriminologjia, UNIVERSITETI AAB, Fakulteti juridik Master Penal
 Legjislacioni dhe praktikat e rajonit në luftimin e krimit të organizuar dhe pasurisë së
 paligjshme” Literature nga ligjëratat në Kolegjin FAMA, Prishtine

Gluščić, Stjepan, Mbështetje për promovimin e mirëkuptimit reciprok në mes të vendeve të Bashkimit Evropian dhe Ballkanit
 Perëndimor, Raport nacional, DREJTËSIA DHE PUNËT E BRENDSHME, nën Marrëveshjen e Grantiti Specifik RELEX I-2 190202
 REG 4-14, Cepor, 2004

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Transparency International Kosova (TIK), faqe 6, tetor 2011

PËRAFRIMI I LEGJISLACIONI PENAL SHQIPTAR ME ATË TË BASHKIMIT EUROPIAN

ELENA XHINA

Avokate, Elbasan

Universiteti Europian i Tiranës, Shkolla doktorale Fakulteti Juridik, E drejtë

publike xhina_elena@yahoo.com

ABSTRAKT

Vendet në tranzicion, të cilët kanë një sistem demokratik dhe shtet ligjor, kanë hartuar legjislacionin e tyre penal, duke respektuar zhvillimet në të drejtën ndërkombëtare, specifikat e brendshme të shtetit të tyre si dhe përpjekjet për tu qasur me legjislacionin penal evropian. Ligji penal shqiptar në dhjetëvjeçarin e fundit ka pësuar ndryshime të herëpashershme, ndryshime këto të cilat lindin nga zhvillimi i vullshëm i shoqërisë dhe evolimi i rendit shoqëror. Aspirata për t'u bërë pjesë e Bashkimit Europian, ka bërë që legjislacioni ynë të shkojë drejt përmirësimit, duke pasur si pikë referimi modelin e ligjit penal të vendeve të europës, duke implementuar në këtë mënyrë një ligj penal sa më efikas dhe efektiv. Ndryshimet në legjislacionin janë shoqëruar me problematika në ngritjen e institucioneve të reja, duke sjellë një impakt të madh në strukturat shtetërore. Sa ka arritur legjislacioni ynë penal t'i përfaqësojë Bashkimit Europian? A gjejnë gjithnjë zbatim ligjet e miratuara dhe cili është ndikimi i ndryshimeve të ligjit penal në shoqëri? A ka ndikuar zhvillimi i shoqërisë në ndryshimin e legjislacionit? Pikërisht në këto pyetje kërkimore do të fokusohet ky punim, duke trajtuar me radhë çdo çështje. Objekt i studimit për zhvillimin e këtij punimi është pikërisht legjislacioni penal, ndryshimet e tij dhe përfaqësimi me Bashkimin Europian.

Fjalë kyç: *Legjislacion penal, përfaqësim ligjor, Bashkimi Europian, vepra penale, Kodi Penal*

1. Hyrje

Historiku i legjislacionit penal daton që nga viti 1912, kur është formuar dhe shteti i parë shqiptar. Qeveria e Vlorës ka shkruar ligje të ndryshme mbi organizimin e drejtësisë në Shqipëri. Sa i përket sistemit të së drejtës penale në Shqipëri, në kuptimin e plotë të fjalës, për të mund të flitet vetëm pas miratimit të Statutit të Lushnjës (1920) deri në vitin 1939.

Me ardhjen e Ahmet Zogut në pushtet, gjatë viteve 1920 - 1928 ligje të ndryshme të drejtës penale janë dekretuar. Në të njëjtën kohë, e drejta shqiptare zakonore (Kanunet), vepronte në zonat malore të vendit. Kodi Penal Shqiptar hyri në fuqi më 01/06/1928. Ky Kodi Penal shënoi shkëputjen e Kodit Penal shqiptar nga ndikimi Osman dhe orientimin drejt Kodit Penal evropian. Një nga parimet më demokratike të këtij Kodi është parimi i ligjshmërisë, sipas të cilit “nuk ka dënim pa ligj” (Nullum crimen, nulla poena sine lege), e cila në vetvete përbën një nga parimet kryesore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Gjatë viteve 1939 - 1944 Shqipëria u pushtua nga të huajt, një faktor historik ky, i cili gjithashtu ka shërbyer në të drejtën penale. Në periudhën 1945 - 1990, në Shqipëri ishte vendosur pushteti i diktaturës së proletariatit dhe luftës së klasës, ku e Drejta Penale dhe Kodi Penal, si pjesë e saj i shërbeu partisë - shtet. Kodi Penal i viti 1952 kishte dispozita që mbrojnë parimin e legjitimitetit, por në këtë kod ashtu si në ligje të tjera penale të asaj kohe, nuk mund të flasim për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Ndryshimet demokratike që ndodhën në fillim të viteve ‘90 në Shqipëri, si dhe tranzicionin nga një sistem totalitar në një sistem demokratik, shënoi një kthesë themelore në historinë e shtetit shqiptar dhe institucioneve të saj. Orientimi demokratik i shtetit kërkoi ndërmarrjen e reformave totale për ndërtimin e shtetit të së drejtës. Për herë të parë, pas periudhës së gjatë të totalitarizmit, parimet themelore demokratike të shtetit të së drejtës, në mesin e të cilat mbrojtja e të drejtave të njeriut, gjeti vendin në ligjin Nr.7491, dt. 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, si dhe më vonë me ligjin Nr.7561, dt. 29/4/1994 “Mbi disa ndryshime dhe amendamente në ligjin Nr. 7491, dt. 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Në kuadrin e reformave institucionale në shtetin e ri demokratik shqiptar, ligjvënësi shqiptar ishte i detyruar për të bërë ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, ndryshime që u aprovuan me ligjin Nr. 7895, dt. 27.01.1995. Kodi i ri Penal u ndërtua në bazë të modeleve bashkëkohore të Kodeve Penale të shteteve demokratike si: Franca, Gjermania, Italia, etj. dhe për kohën që u aprovua, iu përgjigj standardeve ndërkombëtare.

Ligji penal nuk është statik dhe i pandryshuar, përkundrazi ai ka ndryshuar në varësi të kushteve sociale, ekonomike dhe politike të vendit dhe në përputhje me kërkesat objektive të praktikave gjyqësore. E drejta penale shqiptare është në përpjekje të vazhdueshme në rrugën e saj drejt përfaqësjes së legjislacionit me atë të Bashkimit Europian. Ky fakt pasqyrohet në ndryshimet e herëpashershme që kanë karakterizuar Ligjin penal e atë procedural Penal vitet e fundit dhe në këtë punim do të analizohen ndryshimet që konsistojnë kryesisht në drejtim të ekstradimit, krimit të organizuar dhe pastrimit të parave.

Ndryshimet e pasqyruara në Kuadrin ligjor penal e procedural dhe risitë e tyre lidhur me Ekstradimin, Krimin e Organizuar dhe Pastrimin e parave

2.1 Kuadri ligjor sipas të drejtës së brendshme të Republikës së Shqipërisë lidhur me krimin e organizuar dhe ndryshimet në legjislacion në përfaqëse të Bashkimit Europian

Fusha e luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme është një ndër fushat prioritare për Qeverinë Shqiptare si dhe një element shumë i rëndësishëm në kuadër të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Angazhimet e ndërmarra dhe objektivat e përcaktuara shkojnë në një linjë me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit.¹ Këto detyrime parashtojnë domosdoshmërinë e angazhimit të Shqipërisë në nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, për çështje që kanë të bëjnë me luftën kundër krimit të organizuar, migrimit të paligjshëm dhe trafikimit, duke përfshirë në veçanti atë të qenieve njerëzore, kontrabandën, trafikimin e paligjshëm të armëve dhe të makinave, etj. Këto detyrime përbëjnë një faktor kyç për zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në stabilitetin rajonal. Kërkohet angazhimi i Shqipërisë në nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, për çështje që kanë të bëjnë me luftën kundër krimit të organizuar, migrimit të paligjshëm dhe trafikimit, duke përfshirë në veçanti atë të qenieve njerëzore, kontrabandën, trafikimin e paligjshëm të armëve dhe të makinave, etj.

Në fushën e krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme ekziston një bazë e gjerë legjislative, ku si legjislacion parësor mund të përmendet:

Ligji nr. 7895 dt.27.01.1995 “Kodi Penal” të cilit në mënyrë të vazhdueshme janë bërë disa herë ndryshime duke shtuar figura të reja veprash penale kryesisht në fushën e luftës kundër krimit të te organizuar;

Ligji Nr. 7905 date 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të cilit i janë bërë gjatë këtyre viteve një sërë ndryshimesh dhe përmirësimesh në lidhje me procedimin penal të autorëve të krimit dhe aplikimin e teknikave dhe metodave të hetimit;

Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006 për ratifikimin e “Marrëveshjes së stabilizimit-asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve europiane e shteteve të tyre anëtare”

Ligji nr. 8610 datë 17.05.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave” i ndryshuar me ligjin nr. 9804 datë 19.06.2003, hartuar në përputhje me standardet e Bashkimit Europian sipas direktivës 91/308/EC të datës 10.06.1991 “Për parandalimin e shfrytëzimit të sistemit financiar për pastrimin e parave” dhe direktivës 01/97/EC të datës 04.12.2001 e cila amendon direktivën 91/308/EC.

Protokolli i Palermos, i vitit 2000 “Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave veçanërisht të femrave dhe fëmijëve në plotësim të konventës së OKB-së “Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar”.

Ligji nr. 8920 datë, 11.7.2002, “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara, kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” dhe dy Protokolleve shtesë të saj;

Ligji Nr. 9284 datë, 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e Krimit të Organizuar”

Konventa civile “Për korrupsionin” datë, 06.07.2000;

Konventa penale “Për korrupsionin” datë, 26.04.2001;

Konventa “Për pastrimin, zbulimin, sekuestrimin, konfiskimin e të ardhurave nga krimi” datë, 27.01.2006.

2.2 Kuadri ligjor sipas të drejtës së brendshme të Republikës së Shqipërisë lidhur me ekstradimin dhe ndryshimet në legjislacion në përfaqje të Bashkimit Europian

Periodha e pas viteve 1990 ishte periodha kur u zhvilluan marrëdhëniet e bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe autoriteteve të huaja. Pas vitit 1990 Shqipëria ratifikoi mjaft marrëveshje dhe u anëtarësua në disa organizata ndërkombëtare për të përmirësuar dhe për ta çuar në një tjetër stad bashkëpunimin në fushën penale. Gjithashtu modernizimi i legjislacionit, me hyrjen në fuqi të K. Penal dhe K.Pr. Penale e afroi legjislacionin shqiptar me atë europian.

Kushtetuta e RSH-së si ligji themelor i shtetit parashikon parimet kryesore në lidhje me ekstradimin. Nëse do ti referohemi nenit 39 do të vëmë re se Kushtetuta jonë përcakton se ekstradimi lejohet vetëm nëse ekziston marrëveshje ndërkombëtare për këtë dhe Shqipëria është palë. Gjithashtu theksohet se kjo mund të bëhet vetëm me vendim gjyqësor. Një tjetër parim që mund të përmendim është ai i mos gjyqimit dy herë për të njëjtën vepër, konkretisht shprehur në nenin 34 të Kushtetutës. Kjo është mjaft e rëndësishme në lidhje me institutin e ekstradimit pasi nuk mund të bëhet ekstradimi i një personi ndaj të cilit është dhënë vendim nga shteti ku ai ndodhet për veprën penale për të cilën kërkohet. Kushtetuta e shtetit Shqiptar i kushton rëndësi edhe parimeve në lidhje me procesin e rregullt ligjor, përthithjen e normave ndërkombëtare dhe përshtatjen e tyre me normat e brendshme të shtetit.

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë i kushton mjaft rëndësi marrëdhënieve juridikionale me autoritetet e huaja. Më konkretisht në Titullin X, Kreu I, në Seksionet I dhe II parashikohen dispozitat përkatëse të cilat rregullojnë procedurën që duhet të zbatohet për ekstradimin e një personi për jashtë shtetit dhe nga jashtë shtetit. Nga neni 488 deri tek neni 504 ky kod i dedikohet këtij instituti duke filluar nga kuptimi i ekstradimit e duke vijuar me të gjithë procedurën që duhet zbatuar nga organet përkatëse. Nenet në vijim përcaktojnë formën në të cilën paraqitet kërkesa për ekstradim si dhe organin kompetent, rastet e mospranimit të kësaj kërkesë, kushtet për ekstradim, veprimet që ndërmerr prokurori, masat shtrënguese, sekuestrimet, procedurën e arrestimit nga policia gjyqësore. Më tej akoma në nenin 498 përcaktohen rastet kur gjykata jep vendim në favor ose kundër ekstradimit, duke vazhduar me nenet vijuese në lidhje me pezullimin e dorëzimit, kalimin transit, shpenzimet... etj e duke përfunduar me nenin 504 i cili parashikon organin kompetent që është Ministria e Drejtësisë bashkë me tagrat e saj në lidhje me kërkesën për ekstradim nga jashtë shtetit. Në mënyrë më të zgjeruar, në kapitullin pasardhës do të shqyrtohet procedura mbi ekstradimin sipas dispozitave përkatëse të K.Pr. Penale duke analizuar dhe shqyrtuar më me imtësi nenet respektive të këtij kodi në lidhje me këtë institut të së drejtës.

Së fundi, por jo nga rëndësia si pjesë e legjislacionit të brendshëm që rregullon marrëdhëniet mbi ekstradimin nuk mund të mos renditet *Kodi Penal* i Republikës së Shqipërisë. Në pjesën e parë ku përcaktohen dispozitat e përgjithshme të këtij kodi, konkretisht në nenin 11 të tij përcaktohen rastet kur mund të lejohet dhe kur nuk mund të lejohet ekstradimi i një personi. Në këtë nen shprehen qartë kushtet primare pa prezencën e të cilave nuk mund të vihen në zbatim procedurat konkrete për të ekstraduar një individ. Jo më kot neni i cili rregullon këtë institut qëndron me dispozitat e përgjithshme ku sanksionohen dhe parime të tjera të së drejtës penale dhe konkretisht në kreun e parë i cili trajton ligjin penal dhe zbatimin e tij. Ashtu siç janë mjaft të rëndësishëm parimet e tjera si për shembull zbatimin e ligjit penal për vepra penale të kryera nga shtetas të huaj apo fuqia e vendimeve penale të gjykatave të huaja... etj, po kaq rëndësi ka edhe instituti i ekstradimit nëpërmjet të cilit fuqia e ligjit bëhet më efikase duke mos krijuar mundësinë që personat të cilët konsumojnë vepra penale të shmangen nga kjo përgjegjësi.

2.3 Kuadri ligjor sipas të drejtës së brendshme të Republikës së Shqipërisë lidhur me pastrimin e parave dhe ndryshimet në legjislacion në përfaqje të Bashkimit Europian

Për të parandaluar legalizimin e mjeteve monetare apo të pasurive të tjera të përfituara në rrugë joligjore, shumë shtete në botë, në legjislacionet e tyre penale, parashikojnë këtë veprimtari si vepër penale. Në legjislacionin tonë, kjo dukuri kriminale fillimisht gjeti pasqyrim në ligjin nr.8610, 17 maj 2000, “Mbi parandalimin e pastrimit të parave”. Ky rregullim i parë ligjor kishte rëndësi jo vetëm për anën konceptuale të kësaj veprimtarie kriminale, deri në atë kohë e panjohur dhe e papërcaktuar, por edhe në rrafshin praktik, pasi institucionalizoi luftën e organizuar ndaj tij.

QPZ - Përmbledhje e Akteve Ndërkombëtare për Drejtësinë, Tiranë 2006

Rëndësi të veçantë në këtë ligj merr integrimi i vendit tonë në luftën që bën bashkësia ndërkombëtare. Për këtë qëllim, në nenin 15 parashikohet bashkëpunimi me institucionet dhe organizmat ndërkombëtarë për investigimin dhe marrjen e masave ligjore, si ato që kanë të bëjnë me konfiskimin e mjeteve dhe të ardhurave të rrjedhura nga veprimtaria kriminale, identifikimin dhe gjetjen e burimeve të pasurive kriminale, problemet e ekstradimit etj.³ Në vitin 2008 ky ligj pësoi përmirësime të ndjeshme me ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, në nenin 1 të të cilit jepet qëllimi dhe përmbajtja e tij kur thuhet se: “Ky ligj ka për qëllim të parandalojë pastrimin e parave dhe të produkteve që burojnë nga veprat penale, si dhe financimin e terrorizmit”⁴. Në të përcaktohet se çfarë përfaqëson kjo dukuri. “Pastrimi i produkteve të veprës penale” ka të njëjtin kuptim si në nenin 287 të Kodit penal”⁵. Ndërsa për produktin e kësaj vepre penale shprehet se: “Produkt i veprës penale” ka të njëjtin kuptim si në nenin 36, pika 1, shkronja “b”, të Kodit penal”⁶.

Siç përmendëm edhe në fillim të kësaj çështje krahas rëndësisë dhe anëve pozitive, si parandalimi i kësaj veprimtarie kriminale, duhet të themi se në ligjin nr. 8610, datë 17.05.2000, “Mbi parandalimin e pastrimit të parave”, në legjislacionin tonë penal mungonte formulimi i një dispozite ku të përcaktohej kjo veprimtari kriminale si vepër penale dhe të parashikohet ndjekja penale dhe dënimi i subjekteve përkatëse. Kjo u realizua me daljen e ligjit nr. 9086, 19.06.2003, ku jo vetëm plotësohen mangësitë e konstatuara, por i bëhen rregullime të konsiderueshme kornizës përkatëse ligjore. Me ligjin e mësipërm nr. 9086, datë 19.6.2003, përveç përcaktimit si vepër penale të “pastrimit të produkteve të veprës”, në legjislacion janë bërë edhe këto ndryshime të rëndësishme në funksion të këtij krimi, si p.sh.:

Përmirësimi i nenit 7 i Kodit penal në pjesën e përgjithshme, që bën fjalë për zbatimin e ligjit penal për vepra penale të kryera nga shtetas të huaj, duke parashikuar paragrafin shtesë që mungonte pas shkronjës g, me këtë përmbajtje: “... Pastrimi i produkteve të veprës penale...”, sipas rregullimit të ri, shtetasit e huaj do të përgjigjen në bazë të ligjit penal të Republikës së Shqipërisë edhe për pastrimin e produkteve të veprës penale⁷.

Përmirësimi i nenit 30 të Kodit penal që flet për dënimet plotësuese dhe konkretisht i pikës 2 duke e riformuluar atë si më poshtë: “Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale” (pjesa e dytë e këtij paragrafi shtesë nuk përfshihej më parë).

Ky riformulim, ashtu si dhe ndryshimi i nenit 36 të Kodit Penal, kanë të bëjnë me konfiskimin e mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të kësaj veprimtarie kriminale, që rregullonte problemin e diskutueshëm në legjislacionin tonë penal, atë të konfiskimit të të mirave materiale që rrjedhin nga krimi. Ky plotësim kërkohej edhe nga marrëveshja ndërkombëtare për këtë vepër kriminale, ku vendi ynë ka aderuar⁸.

Fillimisht, në kuadrin e plotësimit të legjislacionit përkatës për pastrimin e parave të pista, në Kodin penal u bë plotësimi i nenit 287, me atë 287/a, të titulluar “pastrimi i parave të pista”. Në nenin 8 të ligjit 9086, datë 19.06.2003, thuhet: “Në nenin 287 ndryshohet terminologjia nga “tjetërsimi i pasurisë” në “pastrim të produkteve të veprës penale” dhe saktësohet brendia e tij.

Kësaj dispozite, me ligjin nr. 9275, datë 16.09.2004, iu shtua shkronja “dh” me këtë përmbajtje: “dh”. Përdorimit dhe investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave ose sendeve që janë produkte të veprave penale⁹. Ndërsa në vitin 2007 ndryshohet shkronja “a” dhe shfuqizohet shkronja “ç”¹⁰. Me këtë ligj pësoi ndryshim edhe neni 287/a i Kodit penal dhe emërtohet nga “pastrimi i parave të pista” në “çelja e llogarive anonime”, sipas të cilit: “...Çelja e depozitave ose llogarive bankare, anonime ose me emra të rremë dënohet me burgim deri në tre vjet dhe me gjobë nga 200 mijë lekë deri në 2 milionë lekë...”¹¹. Po në këtë kuadër ndryshimesh, ligjvënësi me të drejtë ka parashikuar shtimin e një dispozite të re, atë për mos deklarimin në kufi të të hollave dhe sendeve me vlerë, që pasqyrohet në nenin e shtuar 179/a, sipas të cilit: “...Mos deklarimi, në hyrje ose dalje nga territori i Republikës së Shqipërisë, i shumave në të holla i çdolloj forme, të çekut bankar, metaleve ose gurëve të çmuar, si dhe i sendeve të tjera me vlerë, përtej vlerës së parashikuar nga ligji, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim deri në dy vjet...”¹². Pra, siç shihet, me korrigjimet e bëra në legjislacionin plotësohet vakuumi i konstatuar në fushën e kriminalizimit të pastrimit të parave, të cilat sistemi ynë ligjor penal tashmë i trajton si vepra penale dhe që mungonte në të kaluarën. Por, pavarësisht nga përparimi i bërë në krahasim me të kaluarën, mendoj se ligjvënësi duhet të shohë mundësinë e përfshirjes së dispozitave shtesë në Kodin penal si dhe formulimin më të plotë të legjislacionit ekzistues, si trajtimin më të gjerë të institutit të konfiskimit të të mirave materiale që rrjedhin nga krimi, për të cilin kam mendimin se në legjislacionin tonë penal një gjë e tillë parashikohet në përgjithësi.

Rekomandime

Ndryshimet e herëpashershme në kuadrin ligjor penal e atë procedural penal shpesh here mund të sjellin dhe amulli në zbatimin e drejtësisë në praktikën gjyqësore. Legjislativi duhet të ketë në konsideratë faktin se ndryshime në ligjet penale

³ Ligji nr. 9917, datë 19.15.2008, ”Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, neni 2, pika 9

Po aty, neni 2, pika 11.

Po aty, neni 2, pika 13.

⁶ Ligji nr. 9917, datë 19.15.2008, ”Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, neni 4

Shih ligjin nr. 9086, datë 19.06.2003, neni 1, faqe 1.

Po aty, ligji nr. 9086, datë 19.06.2003, neni 3 dhe 4.

Ligji nr. 9575, datë 16.09.2004

Ligji nr. 9686, datë 26.02.2007

Ligji nr. 9086, datë 19.06.2003.

Ligji nr. 9086, datë 19.06.2003, neni 6

materiale dhe procedurale, duhet të jenë rrënjësore, të kenë si bazë të tyre efektivitetin, korrektësinë dhe natyrën parandaluese. Vihet re se sanksionet e reja dhe aktet në zbatim të tyre nuk janë plotësisht specifike dhe të mjaftueshme. Në këto kushte herë pas here lind si nevojë krijimi i një sistemi vlerësues për të analizuar efektivitetin e legjislacionit. Ndryshimet në legjislacionin penal shqiptar, të cilat kanë për qëllim përqasjen me bashkimin Europian duhet të kenë si objektiv të tyre dhe krijimin e Institucioneve të reja, të cilat do të kenë si detyrë zbatimin në praktikë të legjislacionit.

Bibliografia

Burime parësore

- Ligj, Nr.7895, dt.Aktit:27.01.1995, dt.miratimi:27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, Fletore zyrtare nr.2, Tiranë, fq. 23
- Ligj, Nr.8175, dt.Aktit:23.12.1996, dt.Miratimit:27.12.1996 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, Fletore zyrtare nr.29, Tiranë, fq. 965
- Ligj, Nr. 8733, dt. Aktit: 24.01.2001, dt. Miratimit: 24.01.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, Fletore zyrtare nr.4, Tiranë, fq. 100
- Ligj, Nr. 9275, Dt.Aktit: 16.09.2004, Dt.Miratimit: 16.09.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Fletore zyrtare nr.69, Tiranë, fq. 459
- Ligj, Nr. 9686, dt. Aktit: 26.02.2007, dt. Miratimit: 26.02.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Fletore zyrtare nr.27, Tiranë, fq. 489
- Ligj, Nr. 10023, Dt. Aktit: 27.11.2008, Dt. Miratimit: 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Fletore zyrtare nr.190, Tiranë, fq. 9395
- Ligj, Nr.23/2012, Dt. Aktit: 01.03.2012, Dt. Miratimit: 01.03.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Fletore zyrtare nr.26, Tiranë, fq. 1299.
- Ligji nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006 për ratifikimin e “Marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve europiane e shteteve të tyre anëtare”
- Ligji nr. 9917, datë 19.15.2008, ”Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”; Ligji nr. 9086, datë 19.06.2003 “Për pastrimin e produkteve të veprës penale”;
- Ligji nr. 9575, datë 16.09.2004 “Përdorimi dhe investimi në veprimtari ekonomike ose financiare të parave ose sendeve që janë produkte të veprave penale”;
- Ligji nr. 9686, datë 26.02.2007 “Për ndryshimin e ligjit nr.9575, datë 16.09.2004”;
- Ligji nr. 8610 datë 17.05.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave” i ndryshuar me ligjin nr. 9804 datë 19.06.2003, hartuar në përputhje me standardet e Bashkimit Europian sipas direktivës 91/308/EC të datës 10.06.1991 “Për parandalimin e shfrytëzimit të sistemit financiar për pastrimin e parave” dhe direktivës 01/97/EC të datës 04.12.2001 e cila amendon direktivën 91/308/EC;

Burime dytësore

- Elezi, I. (2001), Komentari i shtesave dhe ndryshimeve në Kodin Penal me ligjin nr.8733, dt.24.01.2001, albin, Tiranë
- Elezi, I. (2001), Vështrim i Shkurtër Historik i Drejtësisë Penale në Shqipëri dhe sfidat para saj, <http://drejteshqiptare.com> 13.30, 20.06.2013
- Elezi, I. (2009), E drejta penale (Pjesa e posaçme), ERIK, Tiranë
- Elezi, I., Kaçupi, S., Haxhia, M. (1999), Komentari i Kodit Penal të R.Sh., SHBLU, Tiranë J.
- Pradel, G. Corstens, G. Vermeulen.(2009), E Drejta Penale Evropiane, Botimet Papyrus
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit,(2006), Raporti i të drejtave të njeriut në Shqipëri (1997-2003), fq.40,78.
- Muçi, Sh. (2007), E drejta penale (Pjesa e Përgjithshme), Botimet Dudaj, Tiranë
- Përmbledhje të Akteve Ndërkombëtare - botim i Qendrës Publikimeve Zyrtare, Qershor 2010
- Shegani,A. (2007), E Drejta Penale e Krahasuar, Tiranë.

DREJTËSIA NË KOSOVË PËRBALLË SFIDAVE 16-VJEÇARE TË SISTEMIT PARALEL TË SERBISË

HAKI KABASHI

ABSTRAKT

Përfundimi i luftës 1998/1999 Kosovën e gjeti me dy qeveri, (Qeveria e Bujar Bukoshit dhe Qeveria e Përkohshme e Hashim Thaçit) të cilat Administrata Civile e OKB-së (konform autorizimeve të Rezolutës 1244 të KS të OKB të datës 10 qershor 1999) me datën 14 janar të vitit 2000 me një Rregullore të veçantë i kishte transformuar dhe kishte formuar Këshillin Transitor të Kosovës si organ konsultativ. Misioni i OKB i quajtur „United Nation Mission Interim in Kosovo” (UNMIK-KOSOVO) udhëhiqej nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së me mandat ekzekutiv dhe legjislativ. Në mars të vitit 2000 UNMIK-u kishte themeluar Departamentin e Drejtësisë i cili varej nga shtylla e parë e UNMIK-ut (Shtylla e Policisë dhe Drejtësisë) i cili ishte përgjegjës për sistemin e Drejtësisë në tere territorin e Kosovës, riaktivizimin e Gjykatave, Prokurorive Publike, Avokatisë dhe Shërbimit Korrektues. Përkundër rezultateve në stabilizimin e situatës së sigurisë i ndihmuar edhe nga forcat e KFOR-it, UNMIK-u nuk arriti të rifunksionalizoj sistemin e gjyqësisë në tërë territorin e Kosovës. Nga ajo kohë e deri më sot, edhe përkundër bisedimeve politike dhe ndërhyrjeve të ndërkombëtarëve sistemi i drejtësisë së UNMIKut e as ai Republikës së Kosovës (pas Shpalljes së Pavarësisë me 17 shkurt 2008) nuk është shtrirë në tërë territorin e Kosovës gjegjësisht në Mitrovicën e Veriut ku jeton komuniteti serb. Serbia në bashkëveprim me disa përfaqësues të punësuar në UNMIK dhe me ndihmën nga zyrtar të lartë nga OKB-ja të cilët në mënyrë të heshtur kanë pranuar funksionimin e sistemit paralel serb në territorin e Kosovës (në fushën e drejtësisë, gjykata paralele, policia-MUP-i serb, shërbimi i gjeodezisë, kadastrit, shërbimit civil, shëndetësor, arsimor, telekomunikimi, energjetika etj) ka arritur ta sfidoj bashkësinë ndërkombëtare dhe vet UNMIK-un. Edhe pse një organizim i tillë i sistemit paralel dëmton në radhe të parë vet serbet kosovar të cilët për shkak të ndryshme objektivë nuk arrijnë realizimin e të drejtave të tyre ai ende po vazhdon. Gjithashtu po vazhdon injorimi i serbeve kosovar që të përfitojnë të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës e që i referohen sferës së punësimit, arsimit, shëndetësisë, realizimit të të drejtave trashëgimore, të drejtën e pronës, sferës së drejtësisë etj. Përkundër të gjitha këtyre garancive kushtetuese, Qeveria e Republikës së Kosovës ka kërkuar ndihme juridike nga BE, ka kërkuar gjyqtar dhe prokuror ndërkombëtar të cilët në kuadër të Misionit EULEX kanë ardhur në Kosovë të ndihmojnë në fushën e zbatimit të ligjit.

Që gjendja të ndryshoj, Republika e Kosovës bashkë me partneret ndërkombëtar duhet të avancojnë në sistemin e drejtësisë konform Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Kartës Europiane të të Drejtave të Njeriut me qëllim që të ndërpritet sistemi paralel serb i cili ende po funksionon si i tillë gjithandë shtetit Serb e që është në kundërshtim me të gjitha parimet e drejtësisë. Me arritjen e këtij qëllimi do arrihet edhe pajtimi ndërnacional dhe ndëretnik, do hapet një perspektive e re në Bashkimin European.

Fjalë kyç: Rezoluta, Kosova, UNMIK, Sistemi Paralel, Drejtësia

Hyrje

Në shumë shkrime të ndryshme nga studiues të huaj dhe shqiptar, Kosova paraqitet si një etnitet i veçantë administrative-politike, nacional, gjeografik dhe historik me një rrugëtim të vështirë për liri dhe pavarësi politike e kombëtare. Në periudhën e sundimit Osman, Kosova ishte njësi e veçantë administrative dhe njihet me emrin “Pashallaku i Kosovës”¹. Pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë (28 nëntor 1912), Kosova ra nën okupimin serb e malazez për të rënë përfundimisht nën sundimin e Mbretërisë Serbe, Kroate dhe Sllovene (1 dhjetor 1918) dhe deri në vitin 1921 njihet me emrin e saj “KOSOVO”, nga viti 1921 deri në vitin 1929 territori i saj ndahet në tri banovina (në mes të Banovina e Zetës, Banovina e Moravës dhe Banovina e Vardarit”. Me ndarjet administrative të vitit 1939-1941 ajo shndërrohet në „Qarku i Prishtinës-Prishtinski Okrug”².

Gjatë luftës së Dytë Botërore, Kosova pushtohet nga Italia, (pjesa jug perëndimore) Gjermania (pjesa veriore për rreth Mitrovicës) dhe Bullgaria (pjesa lindore e saj). Në pjesën me të madhe të saj e cila ishte nën sundimin Italian e gjerman pati një ngritje kulturore e politike. Shkolla dhe arsimit shqiptar ishte në rritje, sistemi i drejtësisë drejtohej nga Qeveria e Tiranës. Në kushtet dhe rrethanat e krijuara nga pushtimi i tillë dhe nën ndikimin e lëvizjeve antifashiste në Shqipëri dhe rreth saj, rinia antifashiste e Kosovës filloj organizimin e armatosur nën drejtimin e Komitetit Krahinor të Kosovës. Krahas luftës së armatosur, kosovaret filluan edhe luftën politike me qëllim që përfundimi i kësaj lufte ta gjente atë si pjesë e shtetit amë-Shqipërisë nga ku ishin ndarë padrejtësisht. Për realizimin e kësaj ideje, me datën 31 dhjetor 1943 dhe 01/02 janar 1944 ishte mbajtur një Konferencë në fshatin Bujan në Malësinë e Gjakovës ku delegatët nga mbarë Kosova, serb, malazez, boshnjak e shqiptar nënshkruan një deklaratë sipas së cilës ishte vendosur që Kosova pas luftës antifashiste t’i bashkohej Shqipërisë.

Megjithë qëllimin e mirë, Deklarata e Bujanit nuk ishte pranuar nga Jugosllavia e Titos i cili në pranverën e vitit 1945 vendos administrimin ushtarak në Kosovë dhe nën një trysni policore ushtarake, në Prizren, në kuvendin e ashtuquajtur “Kuvendi i Prizrenit” pjesëmarrësit e tij nxjerrin një “Rezolutë mbi aneksimin dhe Bashkimin e Kosovës dhe Metohisë me Serbinë Federale”! Pas këtij “bashkimi me Serbinë Federale”, më 10 korrik të vitit 1945 në Kosovë formohet Gjykata e Lartë e njohur si Gjykata Popullore e Rajonit Autonom të Kosovës dhe Metohisë jetëgjatësia e së cilës ishte vetëm për një muaj e gjysmë. Me nxjerrjen e Ligjit mbi Rregullimin e Gjykatave Popullore të Jugosllavisë i datës 25 gusht 1945 kjo gjykatë shndërrohet në gjykatë të Qarkut ndërsa gjykata me e lartë ishte Gjykata Supreme e Serbisë e cila kishte një degë të saj në Kosovë. Sipas Kushtetutës së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë të vitit 1946, Kosovës i njihet subjektiviteti i dyfishtë: si pjesë e federatës dhe si pjesë e Republikës Popullore të Serbisë e quajtur “Kosovski Metohijski Oblast”, me përfaqësim të drejtpërdrejtë prej 15 delegatësh në Këshillin e Kombeve në Kuvendin Popullor të RFP të Jugosllavisë, me Statutin e saj si akti më i lartë juridik. Sipas Statutit, Rajoni Autonom i Kosovës dhe Metohisë kishte organet e saja Kuvendin, Këshillin Ekzekutiv por nuk kishte kompetencë në fushën legjislativë, gjyqësorë dhe sigurisë.

Me ndryshimet kushtetuese të vitit 1963, Kosova emërtohet nga „Rajoni i Kosovës “Metohisë” në “Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë”. Pas Plenumit të Brionëve të korrikut të vitit 1966 (rrënja e ish ministrit të MPB Aleksandër Rankoviçit) Kosova avancoj pozitën e saj juridike. Në vitin 1967 emri “Metohija” fshihet nga përdorimi zyrtar dhe emërtohet në “Krahina Socialiste Autonome e Kosovës”. Me datën 24 shkurt 1969 Kosova nxjerr Ligjin Kushtetues, sipas të cilit ligj formohet Gjykata Supreme e Kosovës si gjykatë e instancës së fundit me kompetencë në tërë territorin e Kosovës. Me ndryshimet juridike kushtetuese të vitit 1974, Kosova për herë të parë në sistemin juridik të ish Jugosllavisë fiton subjektivitetin juridik dhe konstituiv të Federatës, në kuadër të së cilës funksiononte pushteti Legjislativ-Kuvendi i Kosovës, Këshilli Ekzekutiv (Qeveria) dhe gjyqësor (Gjykata Supreme⁴ dhe Gjykata Kushtetuese). Pra, me kushtetutën e vitit 1974 në Kosova organizon tërë sistemin e drejtësisë unik në tërë territorin e saj, (gjashtë Gjykata të Qarkut në tërë Kosovën, Gjykata Komunale, Gjykata Komunale për Kundërvajtje, Prokurori Publike, Gjykata e Lartë për Kundërvajtje, Gjykata Themelore Ekonomike me seli në Gjakovë dhe Gjykata Ekonomike e Qarkut me seli në Prishtinë, Gjykata e Lartë Ekonomike në Prishtinë), sistemin korrektues, Këshillat e Pajtimit dhe institucionin e avokatisë së Kosovës.

Përkundër garancisë së autonomisë në Kushtetutën e RSFJ, Republika e Serbisë, më 23 mars të vitit 1989 ndërhyri në mënyrë kundër kushtetuese kundër Kosovës, abrogoj sistemin politik, gjyqësor, arsimor, shëndetësor, financiar etj.⁵ të cilin ndryshim e sanksionoj në Kushtetutën e saj (1990), rikthej emërtimin e vjetër në “Kosovo i Metohija”, rikthej Statutin si aktin më të lartë juridik për Krahinën i cili akt asnjëherë nuk është nxjerr deri me sot. Duhet cekur se e gjithë kjo ndërhyrje kundër Kosovës ishte aprovuar në heshtje nga faktori politik në Jugosllavi, të cilët për te realizuar qëllimet e tyre nuk dëshironin të ballafaqoheshin me nacionalizmin e Millosheviçit. Se ata ishin të pajtimit me veprimet e Millosheviçit tregon e dhëna se këto ndryshime janë festuar bashkërisht dhe në mënyrë solemne duke e thyer pogaçen serbe në Qendrën Sava në Beograd me datën 28 qershor të vitit 1989. Në pranverën e vitit 1990 Sllovenia, Kroacia, Bosnjë Hercegovina dhe Maqedonia shpallën pavarësinë nga RSF e Jugosllavisë e cila pas secesionit të këtyre republikave quhej Republika Federative e Jugosllavisë (1992-2002) e cila pas këtij viti shndërrohet në Unioni Serbi & Mali i Zi (2003-2006). Bazuar në referendumin për pavarësi të majit 2006,

http://en.wikipedia.org/wiki/Kosovo_Vilayet#/media/File:Balkans_at_1905.jpg

Between 1922 and 1929, the Kingdom of Serbs, Croats and Slovenes was subdivided into 33 Oblasts shih http://en.wikipedia.org/wiki/Kingdom_of_Yugoslavia

Sipas nenit 1 të Kushtetutes të vitit 1974, Jugosllavija shpallet shtet federativ në perberje të se ciles jane 6 republika dhe dy krahina autonome, me nje autonomi të gjere politike, kulturore, ekonomike dhe gjyqesore. Kufijte e republikave dhe Krahinave të federates

Jugosllave kane qene te paprekshem e, dhe kjo paprekshmeri e kufujve te njesive federale garantohej me nenin 4 te kesaj kushtetute.

Ligji mbi Gjykatat e Rregullta të KSAK (Gazeta Zyrtare KSAK nr.21/78 dhe 49/79), Prishtinë, 1979

Kushtetuta e RSFJ (1974), Pa pelqimin e të gjithë antarve të federatës (8 njesi konstituive) nuk mund të bëhej ndryshimi I kufijve të

brendshëm e as ndryshimi i kufirit shtetror i RSFJ (Neni 5)

Mali i Zi shpall pavarësinë nga Serbia në korrik të vitit 2006. Pas pavarësisë së Malit të Zi Serbia e shpall veten Republika e Serbisë. Duhet cekur se gjatë gati një dekade të shekullit të fundit të shek. XX, Serbia, mbështetur në fuqinë ushtarake të ish-Armatës Jugosllave zhvilloj luftëra të tmerrshme në gati tërë territorin e ish-Jugosllavisë e cila përfundoj me shpërbërjen e plotë të ish-Federatës, shpërbërja e të cilës u vendos në konferenca ndërkombëtare (Marrëveshja e Dejtonit (Ohaio- SHBA 1995) dhe në Marrëveshjen e Kumanovës-Kumanovë, Maqedoni, me 10 qershor 1999. Megjithatë, duhet cekur se deri tek përfundimi i konfliktit u investua shumë nga faktori ndërkombëtar dhe vendor. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit, Serbia e Millosheviçit u drejtua Kosovës e cila në atë kohë kishte organizuar një pushtet paralel dhe një Rezistencë paqësore e u udhëhequr nga Presidenti Ibrahim Rugova i cili njihet si presidenti i parë i Republikës së Parë të Kosovës (e shpallur në vitin 1991) e cila përveç Republikës së Shqipërisë (22 dhjetor 1991) nuk u njoh nga faktori ndërkombëtar.

Duhet pranuar se politika paqësore e Presidentit Ibrahim Rugova ka unifikuar faktorin shqiptar jo vetëm në Kosovë, ka ruajtur popullatën nga reprezaljet policore dhe ushtarake të Serbisë që opinion ndërkombëtar i kishte parë në Kroaci dhe në Bosnje e Hercegovinë. Por, gjithashtu duhet pranuar se Rezistenca Paqësore përballë një Serbie agresive nuk jepte rezultate, lindi krahu i armatosur, Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Me daljen në skenë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, konflikti ushtarak u përshkallëzua për të tejkaluar në një sulm brutal ushtarak e policor të Serbisë të datës 5-7 mars 1998 në familjen e Komandantit të UCK Adem Jasharit në Prekaz, Skenderaj dhe 24 mars 1998 në Glllogjan të Deqanit. Serbia duke shfrytëzuar epërsinë ushtarake dhe rrethanat e krijuara filloj realizimin e një politike për shpërnguljen e popullatës shqiptare nga Kosova në bazë të planit famëkeq "Patkoj". Zbatimi i këtij plani nga ana e forcave policore dhe ushtarake serbe solli pasoja të mëdha për popullatën shqiptare, brenda një periudhe të shkurtë kohore, ushtria, policia dhe paramilitarët serb dogjën fshatra të tëra, vranë me qindra qytetar, gra, fëmijë, pleq, dhunuan me dhjetëra e qindra gra e vajza kosovare, dëbua nga vatrat e tyre me qindra e mijëra civil në Shqipëri Mal të Zi dhe në Maqedoni edhe pse Aleanca e NATO-s kishte filluar bombardimin e caqeve ushtarake të Jugosllavisë së mbetur që me datën 24 mars 1999.

Kjo ndërhyrje ushtarake e NATO-s kundër ish Jugosllavisë zgjati 78 ditë dhe përfundoj me kapitullimin e forcave serbe me 10 qershor 1999 me nënshkrimin Marrëveshjes së Kumanovës mes RFJ dhe NATO-s më të cilën përfundimisht Jugosllavia gjegjësisht Serbia u largua nga Kosovë.

Drejtesia në Kosovë përballë sfidave 16 vjeçare të sistemit paralel të Serbisë

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës, pasoj largimi i forcave ushtarake-policore serbe nga Kosova. Me 12 qershor ne Kosove vendoset Administrata e Përkohshme e UNMIK-ut⁷ e cila në fakt ishte është Protektorat klasik, në krye të të cilit emërohet një administrator me fuqi ekzekutive, legjislativ dhe politike. Duhet cekur se nga data 12 qershor 1999 deri me 14 janar 2000 në Kosovë përveç qeverisë të quajtur UNMIK, vepronin edhe Qeveria e Përkohshme e udhëhequr nga Hashim Thaçi (e dal nga lufta) dhe Qeveria e Bujar Bukoshit (e paraluftës). Meqenëse, liderët e Kosovës për gjashtë muaj rresht nuk arritën të gjejnë gjuhën e përbashkët për mënyrën e qeverisjes, UNMIK-u kërkoi zhbërjen e tyre. Kjo zhbërje e institucioneve të Kosovës juridikisht u legalizua, me Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2000/1 të datës 14 janar 2000 neni 1 pika c) ku thuhet mes tjerash,, Strukturat e tashme të Kosovës, qofshin ato ekzekutive, ligjdhënëse ose gjyqësore, (siç është "Qeveria e Përkohshme e Kosovës", "Presidenca e Republikës së Kosovës", në masën e mundshme dhe në pajtim me këtë rregullore, do të transformohen dhe do të integrohen në mënyrë progresive në Strukturën e Përbashkët të Përkohshme Administrative, e cila do të fillojë punën nga data 31 janar 2000, kur edhe strukturat e tjera të Kosovës të natyrës ekzekutive, ligjvënëse ose gjyqësore do të pushojnë së ekzistuari". Me këtë Rregullore humbet fuqia e faktorit Kosovar i cili inkorporohet në Këshillin e Përkohshëm Tranzitor si organ rekomandues i PSSP-së. Më pastaj edhe ky Këshill inkorporohet në Strukturën e Përbashkët të Përkohshme Administrative (SPPA), ministritë shndërrohen në departamente, ligjet në rregullore, Kushtetuta në Kornizë Kushtetuese, Ushtria në Trupa Mbrojtëse të Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme në Shërbim policor e kështu me radhë.

Pas reformimit të administratës qendrore, kryeadministratori emëroj administrator të UNMIK-ut nëpër Komuna të cilët për punën e tyre i përgjigjeshin direkt atij. Në fushën legjislativ, UNMIK-u filloj nxjerrjen e Rregulloreve dhe udhëzimeve administrative me fuqi ligjore që duhej të zbatoheshin institucionet e përkohshme lokale dhe qendrore të cilat funksiononin qoftë në kuadër të 14 Departamenteve, qoftë në kuadër të katër Shtyllave të UNMIK-ut⁸. Në kuadër të këtyre katër Shtyllave i kushtoj prioritet Shtyllës së parë e cila ishte Policia dhe Drejtësia. Për funksionalizimin e kësaj shtylle, Kryeadministratori emëroj gjyqtar, prokuror dhe polic vendor e ndërkombëtar me ç'rast u krijuar një,,drejtësi hibride"⁹ bazuar ne rregulloret e

Dejtonski sporazum (ili Dejtonski mirovni sporazum ili Dejton), pravni je akt sporazumnog karaktera parafiran u vojnoj zračnoj luci Right-Paterson kod, u američkoj državi, da bi se zvanično prekinuo, koji je trajao od . do .Konferencija je trajala od . godine.

Glavni učesnici su bili bosanski predsjednik, predsjednik, predsjednik, te glavni posrednik i general. Sporazum je zvanično potpisan u 1995. <http://ndesarajevo.org/Dokumenti/Dejtonski-mirovni-sporazum.pdf> parë me datën 13.04.2015

United Nations S/RES/1244 (1999) 10 qershor 1999 REZOLUTA 1244 (1999) ne piken 19 thuhet,, Vendos që prania civile ndërkombëtare dhe e sigurisë, e cila është themeluar për një periudhë fillestare prej 12 muajsh, të vazhdojë me punë edhe pas kësaj periudhe pos nëse Këshilli i Sigurimit vendos ndryshe;"

⁸ United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (UNMIK) has been divided into four sections which it calls "pillars." These are: Pillar I: Police and justice, Pillar II: Civil Administration, Pillar III: Democratization and institution building Pillar IV: Reconstruction and economic development

Bassiouni Cherif M. Introduction to International Law, Transnational Publishers, Inc Ardsley, New York, fq.557

aprovuara nga ana e Kryeadministratorit.¹⁰Duhet cekur se krijimi i institucioneve të drejtësisë nga UNMIK-u daton që nga data 12 korrik 1999,¹¹kur PSSP përmes një korrespondence i kërkonte SP të OKB-së në New York rithemelimin e “Gjykatës së Lartë” dhe aprovimin për pranimin e gjyqtareve dhe prokurorëve në Kosovë.¹² Natyrisht, me aprovimin e SP të OKB-së, rithemelohet institucioni i,.... Gjykatës Supreme të Kosovës e cila ishte abroguar në vitin 1991, të veprorë inter alia, në bazë të ankesave kundër vendimeve të pesë Gjykatave të Qarkut në Kosovë (pika 71)” duke u mbështetur në Rregulloren Nr.1999/5 i datës 4 shtator 1999, së. Në bazë të kësaj Rregulloreje themelohen jo vetëm “Gjykata e Instancës së Fundit” (neni 1 pika 1.1) por i gjithë sistemi gjyqësor më përjashtim Gjykatës Kushtetuese me pretekst se kjo gjykatë implikon UNMIK-un në prejudikimin e statusit final të Kosovës! Pranë Gjykatës Supreme UNMIK-u themelohet një Dhomë të Veçantë me kompetencë shqyrtimin e kontesteve civile mes Agjencionit Kosovar të Privatizimit dhe palëve që kanë interes juridik e ku bëhet fjalë për kontestet pronësore-juridike mbi pronat shoqërore. Me këtë Rregullore rifunksionalizohet Prokuroria Publike e Kosovës (neni 2), përcaktohet mënyra dhe kompetencat e përzgjedhjes së prokurorëve, gjyqtarëve (neni 4) dhe ndihmësgjyqtarë (porotëve), mënyra e shkarkimit të tyre,¹³, mënyra e inicimit të kësaj procedure¹⁴(neni 1 dheneni 4), përzgjedhja dhe angazhimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve ndërkombëtar¹⁵, e deri tek kompetencat administrative mbi administrimin e gjykatave, prokurorive dhe sistemit të burgjeve.¹⁶

Përveç kësaj, në kuadër të veprimtarisë legjislative UNMIK-u aprovoj Kornizën Kushtetuese si akti më i lartë juridik në Kosovë¹⁷duke e shpallur atë si,....një entitet nën administratën e përkohshme ndërkombëtare, që, me popullin e vet, katribute unike historike, juridike, kulturore dhe gjuhësore.(neni 1.1), si,.... një territor i pandashëm anembanë të të cilit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes ...(neni 1.2) dhe,....do të qeveriset në mënyrë demokratike nëpërmjet organeve dhe institucioneve ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore ...(neni 1.4) duke garantuar të drejtat e komuniteteve dhe të anëtarëve të tyre (Kreu 4), përfshirë mes tjerash edhe punësimin e tyre në organet dhe institucionet publike të Kosovës të niveleve lokale dhe qendrore. Punësimi i tyre ishte i garantuar dhe bëhej në bashkëpunim me OSBE (neni 5.3 pika (e) të Kornizës Kushtetuese”. Duhet cekur se të drejtat e komuniteteve ishin kompetencë e rezervuar e PSSP sitë drejta ekskluzive (neni 8.1 pika (a),e që përveç njëzet (20) vendeve që rezervohen për komunitete në Kuvendin e Kosovës (neni 9.1.3, pika (b), dhjetë (10) vende ishin të rezervuara për komunitetin serb të Kosovës.(neni 9.1.3 pika (i), me të paktën dy ministra nga komunitetet e njeri prej tyre duhet të jetë nga komuniteti serb(neni 9.3.5 (a).

Përkundër përpjekjeve të UNMIK-ut dhe IPVQ të Kosovës, komuniteti serb i shtyrë nga Serbia bojkotoj institucionet e saj. Përkundër kompetencave të tij, UNMIK-u nuk arriti të krijoj një sistem unik të drejtësisë dhe sigurisë në Kosovë ashtu siç kërkohet me Rezolutën 1244 të OKB-se¹⁸, nuk arriti të eliminoj sistemin paralel të Serbisë I cili vepron në fushën e gjyqësorisë, sigurisë, PTT, energjisë, tregtisë etj. ku janë të përfshirë struktura kriminale të krimit të organizuar dhe si i tillë është shndërruar në një problem madhor me histori 16 vjeçare që duhet zgjidhur përmes negociatave mes Prishtinës dhe Beogradit në Bruksel.¹⁹

Përpjekjet për inkuadrimin e komunitetit serb të Kosovës në sistemin juridik të saj kanë histori e cila ka filluar me takimet mes përfaqësuesve të UNMIK-ut dhe qeverisë së RFJ-se²⁰që ka rezultuar me një marrëveshje të nënshkruar në nëntor të vitit 2001 ku janë njëmbëdhjetë fusha duke përfshirë edhe fushën e sigurisë dhe drejtësisë me qëllim ndërtimin “e një gjyqësori multi-etnik në Kosovë e Metohi”.

Edhe përkundër kësaj “përkëdheljeje” nga ana e UNMIK-ut kjo marrëveshje nuk ka funksionuar fare sepse është bojkotuar nga ana e Serbisë e cila financon strukturat paralele në territorin e Kosovës mbi të cilin nuk ka sovranitet juridik kushtetues. Për eliminimin e këtij paralelizmi janë rekomanduar zgjidhje edhe në nivel të OKB-se siç është plani prej 8 pikash i njohur si “Standardet para Statusit” i datës¹⁰ dhjetor 2003. Në këtë plan të OKB-së mes tjerash kërkohet krijimi i një sistemi profesional, të paanshëm të drejtësisë në Kosovë e kjo me qëllim që të eliminohet frika e mbivotimit kundrejt komunitetit serb në Kosovë e siç kërkohet në Standardin e I-rë, pika e dymbëdhjetë që,, Strukturat paralele për sigurimin e shërbimeve të jenë zhbërë ose integruar në strukturat e IPVQ-ve”.

Lenë anash ankesat pa arsye të Serbisë që shpreh para faktorit ndërkombëtar për rastin e Kosovës, komuniteti serb në Kosovë gëzon mbrojtje juridike kushtetuese më shumë se secili minoritet në Europë e me gjerë. Këto të drejta kushtetuese janë edhe rezultat i Propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës i datës 26 mars 2007, aneksin e IV (sistemi

Rregullore nr.1999/6 I dates 7 shtator 1999 Për Rekomandimet mbi strukturën dhe Administrimin e Sherbimit të Gjyqësorisë dhe Prokurorisë

UN Security Council S Distr.General S/1999/779

Informate derguar ne OKB ne New York, mbi largimin per ne Serbi te 756 gjyqtarve e prokurorve serb sa kishin punuar ne Kosovë, nga të cilët vetem 30 ishin shqiptar ishin larguar nga Kosovadhe sistemi I drejtesisë ishte ne kollaps (pika 66).

Rregullorja e UNMIK-ut nr 1999/18 I dates 10 nëntor 1999

Rregullorja e UNMIK-ut nr 1999/7 i dates 7 shtator 1999 Per emrimin dhe shkarkimin e Gjyqtarve dhe Prokurorëve nga Detyra, Rregulloren nr 2000/57 I dates 6 tetor 2000

Rregullorja e UNMIK-ut nr 2000/13 I dates 31 maj 2000

Rreg. e UNMIK-ut nr 2000/15, 21 mars 2000 mbi krijimin e Departamentit te Administrates dhe Drejtesise

Rregullore Nr. 2001/9 Per Kornizen Kushtetuese te Vetqeverisjes se Perkohshme ne Kosove,15 maj 2001

Sporazum o saradnji SRJ i UNMIK-a potpredsednik Vlade Srbije Nebojsa Covic, kao Specijalni predstavnik Predsednika SRJugoslavije, Vlade SRJugoslavije i Vlade Republike Srbije i Specijalni predstavnik Generalnog sekretara UN za Kosovo Hans Hakerup, potpisali su u ponedeljak 5. novembra 2001. godine u Palati federacije,Beograd. Mes tjerash flitet edhe per,, Gjykatat- SUDSTVO”

Zakon o sedistima i podrucjima sudova I javnih Tuzilastva Srbije S.G RS br.101/2013, eleminon sistemin paralel, por kerkon qe per sistemin e gjyqsorit ne,,Kosove e Metohi” te nxjerret nje ligj I veqante.

UNMIK-u ka nje zyre ne Beograd, UNOB -United Nation Organization of Belgrade e cila koordinon raportet mes Republikes se Serbise dhe Kosovës), Sporazum o saradnji SRJ i UNMIK-a u ponedeljak 5.novembra 2001 godine u Palati

i drejtësisë) dhe atë të VIII (sektori i sigurisë). Sipas Planit Gjithëpërfshirës, Kosovës i njihet Pavarësia e Kushtëzuar me një garanci kushtetuese të theksuar për komunitetin serb, për kulturën, besimin e tyre, krijimin e Komunës Veriore të Mitrovicës, pjesëmarrjen e tyre në jetën politike dhe institucionale, duke garantuar inkuadrimin e tyre në kuotën prej 15% te numrit të banorëve që do matet në çdo pesë vjet në institucionet publike.

Mbas Shpalljes së Kosovës Shtet Sovran dhe të Pavarur (17 Shkurt 2008), roli i UNMIK-ut është zvogëluar, por Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës i kanë kushtuar vëmendje të madhe respektimit të drejtave të komuniteteve duke iu siguruar një përfaqësim konstitucional në tërë sistemin juridik të Kosovës, administrate, polici²¹, drejtësi²², në Këshillin Gjyqësor²³ dhe Prokurorial të Kosovës²⁴. Bile për të hequr dilemat që ka faktori ndryshëm ndërkombëtar lidhur me organizimin e shtetit të së drejtës në Kosovë, çështja e inkorporimit në jetën institucionale të Kosovës është sanksionuar me një nen të veçantë në Kushtetutë e ku behët fjalë për obligimet që dalin për ketë çështje në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës²⁵. Për të hequr këto dilema, Kosova ka pranuar autoritetin e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar (PCN) të BE-së si një autoritet i pakontestueshëm në Kosovën e kompetenca të mëdha kushtetuese juridike, ka pranuar ofertën e BE-së për ndihmë në sferën e sundimit të Ligjit dhe dërgimin e misionit të EULEX²⁶ nën mandatin e Rezolutës 1244 edhepse ky mision ka qëndrim neutral ndaj statusit të Kosovës. Duhet cekur se ky mision ishte paraparë të vijë në Kosovë diku në prill të vitin 2006 (i njohur si EUPT²⁷) por kjo çështje ishte prolonguar për shkak të kundërshtive mes Këshillit të Sigurimit dhe Unionit Europian. Si rezultat i këtyre kundërshtive në nëntorin e vitit 2008, Sekretari i Përgjithshëm i OKB Ban Ki Mun nxjerr 6 pika famoze më të cilat OKB-ja kryen një „atentat“ në demokracinë e brishtë të Kosovës, përmes të cilit plan përkrahët organizimit paralel i strukturave të Policisë, Doganës së Kosovës, Drejtësisë, Transportit dhe infrastrukturës, Kufijve dhe Trashëgimia Serbe. Në bazë të këtyre pikave të aprovuara në KS të OKB-në New York, të gjitha këto struktura janë jashtë sistemit juridik Kushtetues të Kosovës dhe janë vënë nën autoritetin e UNMIK-ut dhe të EULEX-it që nga viti 2008 e këndej. Bazuar në dokumentacionin aktual del se misioni i Eulex-it ka mandat të dyfishtë, atë të Republikës së Kosovës „mandat fiktiv“ dhe „mandatin real“ të OKB të cilit edhe i raporton. Eulex-i ka ardhur me ftesë të kosovarëve, me një mandat të caktuar për funksionimin e të cilit ekziston një ligj special²⁸ dhe ligje tjera që përcaktojnë veprat penale që ata duhet t'i hetojnë gjatë punës së tyre e të cilat janë të listuara nga neni 441 dhe 442 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Funksionimi i gjykatave paralele të Kosovës në Serbi

Përkundër Marrëveshjeve të nënshkruara me UNMIK-un nga Serbia, ajo asnjëherë nuk i ka respektuar ato, por ka vazhduar financimin e sistemit paralel të Gjykatave, Prokurorisë, policisë, sistemit kadastral, PTT, shëndetësisë, arsimit etj. në territorin Kosovës. Në anën tjetër UNMIK-u i cili ka nënshkruar këto marrëveshje për llogari të Kosovës asnjëherë nuk ka reaguar për këto aktivitete „subversive“ të Serbisë konform kompetencave të Rezolutës 1244 të OKB. Organizimi dhe funksionimi i këtyre institucioneve të cilat funksiononin në emër të Kosovës nuk funksionojnë vetëm brenda territorit të saj por ato shtrihen edhe në brendi të territorit të Serbisë, në qytetet Leskovc, Kragujevc, Vranjë, Nish, Surdulicë e gjetiu. Dihet botërisht se pas datës 10 qershor p.sh. Stacioni i Policisë paralele i Qytetit të Pejës ishte vendosur në qytetin e Kragujevcit cili funksionon edhe sot duke lëshuar dokumente identifikimi dhe udhëtimi (pasaporta serbe) për qytetarët e Kosovës. Në të njëjtin qytet funksionon

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 128, pika 2. Policia e Republikës së Kosovës është profesioniste dhe pasqyron shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës. Pika 4. Policia e Republikës së Kosovës (...) Përbërja etnike e policisë brenda një komune duhet të pasqyron, deri në shkallën më lartë të mundshme, përbërjen etnike të popullsisë brenda komunës përkatëse.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 102 pika 2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasjetë barabartë në gjykata.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 108 pika 1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron pavarësinë dhe paanshësinë e sistemit gjyqësor. Pika 6. Këshilli Gjyqësor i Kosovës përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë, me kualifikime dhe ekspertizë profesionale. Anëtarët emërohen për një mandat pesëvjeçar dhe zgjedhen në këtë mënyrë: (3) Dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit Serb në Kosovë, dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar;

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 103 Pika 3. Të paktën pesëmbëdhjetë përqind (15%) e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, por jo më pak se tre (3) gjyqtarë, do të jenë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Pika 6. Të paktën pesëmbëdhjetë përqind (15%) e gjyqtarëve nga cilado gjykatë tjetër, e themeluar me juridiksionin e apelit, por jo më pak se dy (2) gjyqtarë do të jenë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Pika 10. Kandidatët për pozita gjyqësore të gjykatave themelore, nën juridiksionin e të cilave përfshihet ekskluzivisht territori i një a më shumë komunave, ku shumica e popullsisë i takon komunitetit Serb të Kosovës, mund të rekomandohen për emërim vetëm nga dy (2) anëtarët e Këshillit që i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për komunitetin Serb në Republikën e Kosovës të cilët veprojnë bashkërisht dhe në mënyrë unanime. Neni 110 pika 1 Këshilli Prokurorial i Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 143 pika 2. Dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007 kanë epërsë ndaj të gjitha dispozitave të tjera ligjore në Kosovë.

Council Joint Action 2008/124/CFSP of 4 February 2008 on the EU role of Law Mission in Kosovo, Eulex Kosovo

Ligji nr.03 L-052 Per Prokurorine Speciale te Republikës se Kosoves, Ligji Nr.. 04/L -273 per Ndryshimin dhe Plotesimin e ligjeve qe nderlidhen me mandatin e Misionit te Bashkimit Europian per Sundimin e Ligjit ne Republikën e Kosoves .KODI NR. 04/L-082 KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVI, Neni 441 Dispozitat kalimtare lidhur me juridiksionin e prokurorisë speciale të Republikës së Kosovës, Neni 442 Dispozitat kalimtare lidhur me juridiksionin dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në procedurë penale.

shërbimi paralel i Kadastrit dhe Gjeodezisë i qytetit të Pejës i cili lëshon Certifikata pronësie për persona të interesuar edhe pse pronat e paluajtshme gjenden në territorin e Komunës së Pejës.

Në qytetet e Serbisë funksionojnë gjykata paralele të cilat gjykojnë lëndë të ndryshme penale, kontestimore dhe jo kontestimore sidomos për qytetar të komunitetit serb. Pra, sipas kësaj praktike që po ndjek Serbia, kemi një rast sui generis të funksionimit të „drejtësisë” në një territori pa sovranitet. Pra, kemi dy polici, dy gjykata, dy shërbime me dy epror të organeve, me të njëjtin emër të institucionit por me seli të ndryshme. P.sh. në certifikatat e ndryshme që u lëshohen qytetarëve shkruan “Stanica Policije Pec, Kragujevcu”. Në të njëjtën formë funksionojnë edhe Gjykatat paralele, me vendime paralele dhe të pazbatueshme për të njëjtën çështje. Këto gjykata paralele që gjykojnë në emër të Kosovës veprojnë në bazë të Ligjit mbi selitë dhe territoret e gjykatave dhe Prokurorive Publike të Serbisë i vitit 2008.²⁹

Në bazë të nenit 2 të këtij ligji në Mitrovicë ishte formuar Gjykata për Kundërvajtje me kompetenca territoriale për tërë territorin e Kosovës dhe Metohisë me degët e saja në Gorazhdevc (Pejë), Graçanicë (Prishtinë), Ranillug (Gjilan) dhe Shterpcë (Ferizaj).

Sipas nenit 3, pika 11) është themeluar Gjykata Themelore në Mitrovicën e Kosovës, me kompetencë për tërë territorin e Kosovës dhe Metohisë duke përfshirë edhe degët e saja në Gorazhdevc, Graçanicë, Ranilug dhe Shterpcë.

Sipas nenit 4, pika 7 themelohet Gjykata e Lartë me seli në Mitrovicën e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, me kompetencë për zgjidhjen e çështjeve sipas ankesës së Gjykatës Themelore të Mitrovicës së Kosovës.

Sipas nenit 5, pika 8) Kompetente për gjykimin e çështjeve ekonomike të gjykatave në shkallë të parë caktohet Gjykata Ekonomike në Nish.

Sipas nenit 6, pika 3 Caktohet Gjykata e Apelit në Nish si Gjykatë kompetente për territorin e Mitrovicës së Kosovës. Sipas nenit 7, pika 2 Dega e Gjykatës së Nishit caktohet si gjykatë kompetente e shkallës së dytë për të gjitha gjykatat për kundërvajtje në territorin e Mitrovicës së Kosovës.

Sipas nenit 8, pika 2 Dega e Gjykatës së Nishit caktohet si gjykatë kompetente edhe për territorin e Gjykatës së Lartë në Mitrovicën e Kosovës.

Sipas nenit 9, pika 11) Caktohen kompetencat e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës për territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicën e Kosovës .

Sipas nenit 10, pika 7 Themelohet edhe Prokuroria e Lartë Publike e Mitrovicës së Kosovës me kompetencë për territorin e Gjykatës së Lartë të Mitrovicës së Kosovës.

Sipas nenit 11, pika 3 Themelohet Prokuroria Publike e Apelit me seli në Nish dhe me kompetenca territoriale në territorin e Gjykatës së Apelit në Nish.

Sipas të dhënave që disponojmë del se një organizim i tillë i sistemit të drejtësisë është bërë me pëlqimin e organeve me të larta shtetërorë serbe të drejtësisë³⁰ i cili ka funksionuar si i tillë që nga pas lufta e 1999 e këndeje. Në vitin 2013 pasojnë ndryshimet e Ligjit mbi organizimin e Gjykatave dhe Prokurorive në Serbi sipas të cilit, sistemin gjyqësor të Kosovës, e heq nga sistemi i drejtësisë së Serbisë. Gjithashtu sipas këtij ligji, kur bëhet fjalë për “Kosovën dhe Metohinë” dhe organizimin e Prokurorive dhe Gjykatave paralele në territorin e saj parashihet nxjerrja e një ligji të veçantë që do e rregulloj këtë çështje.³¹ Deri në nxjerrjen e këtij ligji të veçantë, siç thuhet në nenin 17, lëndët të cilat janë në procedurë, goftë në Prokurori ose në gjykata duhet të vazhdojnë procedurën.³²

Sipas nenit 13, posaçërisht nenit 12 pika 2 e ligjit mbi selitë dhe territorin e Gjykatave dhe Prokurorive, lëndët gjyqësore të Gjykatave Komunale paralele të Kosovës kalojnë në kompetencë të gjykatave të Serbisë. Në fakt këtu bëhet fjalë për krijimin paralel të gjykatave të Kosovës me seli nëpër qytetet e Serbisë të cilat gjykojnë çështje të ndryshme që palë të interesuara janë refugjatët serb nga Kosova që jetojnë përkohësisht në Serbi. Duhet theksuar se e tërë procedura para këtyre organeve paralele zhvillohet duke u bazuar në dokumente që lëshojnë organet paralele “kosovare” që veprojnë në Serbi e të cilat dokumente në mënyrë të kundërligjshme i kanë nxjerr nga arkivi me rastin e largimit të tyre në qershorin e vitit 1999 dhe i kanë marr me vete. Si rezultat i këtij paralelizmi juridik e gjyqësor kemi Aktgjykime dhe Aktvendime jo meritore, paralele (për një çështje nga dy Aktgjykime apo Aktvendime) dhe në kundërshtim me të gjitha ligjet që përcaktojnë kompetencat qofshin ato lëndore apo territoriale.³³

²⁹ Zakon o sedistima I područjima sudova i javnih Tuzilastva Srbije, (“Sl. glasnik RS”, br.116/2008) Član 2, Član 3, Član 4, Član 5, Član 6, Član 7, Član 8, Član 9, Član 10, Član 11, Član 12, Predmete u kojima do dana primene ovog zakona nije doneta odluka, od sudova i javnih tužilaštava osnovanih Zakonom o sedištimu i područjima sudova i javnih tužilaštava (“Službeni glasnik RS”, br. 63/01 i 42/02), preuzimaju stvarno i mesno nadležni sudovi i javna tužilaštva, osnovani ovim zakonom, Zakonom o uređenju sudova i Zakonom o javnom tužilaštvu. Član 13, Izuzetno od odredbe člana 12. stav 2. ovog zakona, danom početka primene ovog zakona, predmete pojedinih sudova osnovanih Zakonom o sedištimu i područjima sudova i javnih tužilaštava (“Službeni glasnik RS”, br. 63/01 i 42/02), preuzimaju sudovi osnovani ovim zakonom ...ne territorin e Republikës së Serbisë.

Visoki savet sudstva (Keshilli i Lartë Gjyqësor) i Državno veće tužilaca (Keshilli Shtetror i Prokurorise) obrazovaće komisije koje će donetirešenja o raspoređivanju zaposlenih iz sudova i javnih tužilaštava iz stava 1. ovog člana, u skladu sa privremenim aktom o unutrašnjem uređenju i sistematizaciji radnih mesta, koji će doneti ministar nadležan za pravosuđe do 1. septembra 2009. godine., Član 18, Danom početka primene ovog zakona prestaje da važi Zakon o sedištimu i područjima sudova i javnih tužilaštava («Službeni glasnik RS», br. 63/01 i 42/02),

Zakon o sedistima i područjima Sudova i Javnih Tuzilastva Srbije,,Sl.glasnik RS”,br.101/2013,

Posebni zakon iz člana 12.ovog zakona doneće se do 31. decembra 2013. godine.

Clan 13 Izuzetno od odredbe člana 12. stav 2. ovog zakona, danom početka primene ovog zakona, predmete pojedinih sudova osnovanih

Zakonom o sedištimu i područjima sudova i javnih tužilaštava (“Službeni glasnik RS”, br. 63/01 i 42/02),

Andaj duke shqyrtuar këto praktika që ka ndjek Serbia në lidhje me financimin e sistemit paralel, mendojmë se një përkrahje dhe një financim i tillë i strukturave paralele se pari ndikon në dëmtimin e interesave të vet qytetarëve serb të Kosovës që jetojnë përkohësisht në Serbi. Së dyti, organizimi dhe funksionimi i këtillë i këtyre strukturave paralele në Kosovë apo në qytete të ndryshme të Serbisë është juridikisht i paqëndrueshëm, praktikisht i dëmshëm dhe politikisht tendencioz me pasoja të paparashikueshme pikërisht për ata që kanë nevojë për drejtësi.

Me ndryshimet e tilla ligjore Serbia ka paraparë që lëndët e gjykatave paralele kosovare t'i delegojnë në gjykata të caktuara brenda territorit të Serbisë, kështu:

- Lëndët e Gjykatave Komunale të Vitisë, Gjilanit, Kamenicës i merr Gjykata Themelore në Vranjë,
- Lëndët e Gjykatave Komunale të Vuçitërnës (Vushtrrisë), Mitrovicës dhe Leposaviqit i merr Gjykata Themelore në Kralevë,
- Lëndët e Gjykatave Komunale të Dragashit, Rahovecit, Prizrenit i merr Gjykata Themelore në Krushevc,
- Lëndët e Gjykatave Komunale të Gjakovës, Istogut, Klinës, Pejës, Suha Rekës (Therandës) dhe Ferizajit i merr Gjykata Themelore në Leskovc,
- Lëndët e Gjykatës Komunale të Prishtinës i merr Gjykata Themelore në Nish,
- Lëndët e Gjykatës Komunale të Lipjanit i merr Gjykata Themelore në Prokuplje,
- Lëndët e Gjykatës së Qarkut të Gjilanit i merr Gjykata e Lartë në Vranje,
- Lëndët e Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës i merr Gjykata e Lartë në Kraleve,
- Lëndët e Gjykatës së Qarkut të Pejës i merr Gjykata e Lartë në Leskovc,
- Lëndët e Gjykatës së Qarkut të Prizrenit i merr Gjykata e Lartë në Pozharevc,
- Lëndët e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës i merr Gjykata e Lartë në Nish,
- Lëndët e Gjykatës Ekonomike të Prishtinës i merr Gjykata Ekonomike e Kralevës.

Thënë shkurt, nga e gjithë kjo, lexuesi dhe dëgjuesi e ka të vështirë të kuptoj këtë, anomali juridike” dhe këtë sistem drejtësie ku vendimi i çfarëdo gjykate të tillë mbetet I pa ekzekutuar sepse vepron në një territor pa kompetencë. Serbia, duhet ta kuptoj se në 34 qytetet e Kosovës funksionon sistemi i drejtësisë së Kosovës (përfshirë janë tri qytetet veriore të Kosovës), dhe funksionimi i po kaq gjykatave paralele do dëmtojë më së tepërmi ata që kanë nevojë për drejtësi.. Kjo praktikë e funksionimit të sistemit paralel të Serbisë në një territor pa sovranitet faktik dhe juridik, në një territor me subjektivitet juridik i cili gëzon njohje ndërkombëtare të mbi gjysmës së shteteve anëtarë të OKB-së, dëmton jo vetëm interesat e Kosovës dhe të qytetarëve të saj, por në radhë të parë dëmton interesat ekonomike të vet serbëve të Kosovës, shkel të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, dëmton edhe interesat e Serbisë dhe ndikon në rritjen e kriminalitetit dhe fuqizimin e Krimit të organizuar i cili është mjaft aktiv në tërë orbitën ballkanike dhe paraqet problem të madh në rrugën e integrimi euro-atlantike të të dyja vendeve.

HARTA E KOSOVËS: FUNKSIONIMI I SISTEMIT TË GJYQËSISË PARALELE NË SERBI PAS LUFTËS 1999-2015



Konkluzione

Në Kosovës pas 10 qershorit 1999 dhe vendosjen e saj nën Administratën e Përkohshme të OKB-se (UNMIK-ut) çdo gjë fillon nga e para. UNMIK-u duke shfrytëzuar fuqinë juridike të tij që derivon nga Rezoluta 1244 të KS të OKB-se rikonfiguroj tërë sistemin juridik, administrative, gjyqësor dhe legjislativ. Kjo u vendos posaçërisht me 14 janar 2000, kur UNMIK-u transformoj qeveritë kosovare dhe Presidencën dhe krijoj organet tranzitore të Përkohshme si organ këshill dhënës i cili me pas u inkorporua në Strukturën e Përbashkët të Përkohshme Administrative (SPPA). Bazë e organizimit të tij u bënë katër Shtyllat e UNMIK-ut, Siguri dhe Gjyqësia, Administrata Civile, Demokratizimi dhe ndërtimi Institucioneve dhe Rindërtimi dhe Zhvillimi Ekonomik. Bazuar në këto katër Shtylla, UNMIK-u ndërtoj tërë strukturën funksionale të administratës së tij dhe të Kosovës në veçanti.

Në bazë të këtyre katër shtyllave, ushtroj autoritetin e tij që nga organet lokale ku vendosi administrator komunal e deri në organet qendrore, formoj 14 departamente të ndryshme në kuadër të të cilit ishte edhe Departamenti i Drejtësisë. Bashkë me OSBE formoj Shërbimin Policor të Kosovës i cili ishte nën kompetencat e Komisionerit të Policisë së UNMIK-ut dhe mbikëqyrej nga policia e UNMIK-ut (CIVPOL). Rithemeloj sistemin e drejtësisë duke hapur gjykatat në të gjitha nivelet, duke emëruar gjyqtar dhe prokuror vendor e ndërkombëtar. Në fushën legjislativë nxori shume Rregullore dhe Udhëzime Administrative me fuqi ligjore. Njëra ndër detyrat e UNMIK-ut ishte të krijoj një shoqëri demokratike dhe të ndihmoj në krijimin e institucioneve të Kosovës. Fusha e drejtësisë dhe sigurisë ishin të drejta të rezervuara duke përfshirë edhe kujdesin për komunitete. Në vitin 2001 UNMIK-u nxori Kornizën Kushtetuese e cila ishte akti me i lartë juridik në Kosovë. Në raport me përfaqësimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare ai ishte përfaqësuesi i saj i vetëm. Në këtë kuadër, kryeadministratori i Kosovës kishte negociuar në emër të saj edhe me Serbinë fqinje me qëllim të funksionimit dhe përparimit të shoqërisë kosovare, inkuadrimit e komunitetit serb në Institucionet e Përkohshme të Kosovës. Në anën tjetër, Kryeadministratori ishte një i punësuar i OKB dhe përfaqësonte SP të OKB-së. Përmes tij, u paraqitën projekte siç janë “Standardet para Statusit”³⁴ te vitit 2003, ku mes tjerash kërkohej shuarja e sistemit paralel serb në fushën e gjyqësisë dhe policisë të cilët vepronin në territorin e Kosovës.

Edhe pas Shpalljes së Pavarësisë (17 Shkurt 2008) dhe nxjerrjes së Kushtetutës së Kosovës, ky sistem paralel jo që nuk u shua por ai mori përmasa të reja duke u shtrirë edhe brenda vet territorit të Serbisë (gjykata paralele, polici paralele, zyra kadastrale dhe gjeodezie paralele etj). Duhet cekur se Serbia duke u bazuar edhe në sinjale të gabueshme nga faktori i jashtëm jo vetëm që nuk i ka shuar këto organe paralele por edhe i ka forcuar. Ky sinjal i keq ka ardhur edhe nga plani gjatë pikës së OKB-së Ban Ki Mun, i cili sistemin e drejtësisë, sigurisë, doganën, infrastrukturën etj i nxjerr jashtë kompetencave të Kushtetutës së Kosovës duke i rezervuar si të drejta rezervuara të PSSP të OKB në Kosovë e që praktikisht janë këto fushat kryesore ku kriminelet dhe krimi i organizuar janë mjaft aktiv. Në zonën e Veriut nuk funksionon dogana ashtu siç funksionon në pikat tjera kufitare. Kontrabanda, trafiqet e ndryshme dhe krimi i organizuar funksionon në prezencën e këtyre misionarëve të cilët kanë kompetence ta ndalojnë. Edhe Misioni i Eulex-it me mandat ndihmës dhe këshillues i ftuar nga Qeveria e Kosovës nuk ka arritur të shtrijë autoritetin e sistemit të drejtësisë në tërë territorin e Kosovës. Që nga 01.02.2009 edhe doganat janë në duar të EULEX-it³⁵ por përparimet ndjekin hapat e breshkës. Megjithatë, I gjithë spektri politik vendor dhe ndërkombëtar janë të vendosur të bëjnë ndryshime pozitive duke krijuar kushte për një funksionim më të mirë të sistemit të drejtësisë në Kosovë³⁶ i bazuar në parimet Kushtetute³⁷, dhe në ligjet tjera pozitive³⁸ me qëllim të krijimit të kushteve të punës edhe për EULEX-in që të kryejë detyrën e tij³⁹ në përputhje me ligjin në tërë territorin e Republikës së Kosovës⁴⁰.

Por, përkundër këtyre ndryshimeve ligjore dhe organizative, që shkojnë në dobi të rendit dhe sigurisë dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut e posaçërisht në favor të komuniteteve që jetojnë në Kosovë, përkundër pranisë së Misionit të UNMIK-ut dhe Misionit të Eulex-it lindën dhe u thelluan problemet qoftë brenda përbrenda vet misionit (flitet për korrupsion në përmasa të mëdha të gjyqtareve të këtij misioni) qoftë në mos efikasitetin e këtij misioni në luftimin e krimit dhe shuarjen e sistemit paralel të Serbisë në Kosovë i cili është shndërruar në problem politik duhet të merren disa hapa konkretë.

1. Me qëllim të realizimit dhe funksionalizimit të rendit dhe ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, të rishikohet

Shih, Security Council Report, UN Documents for Kosovo <http://www.securitycouncilreport.org/un-documents/kosovo/>

Nga deklarata e zedhensit të UNMIK-ut Aleksander Ivanko dhene RTK ne lajmet qendrore te dates 23.01.2009

Ketu nuk perfshihet Gjykata Kushtetuese.

Kapitulli 7 i Kushtetutës.

Ligji për Gjykatat (Ligji nr. 03/L-199), Ligji për Gjykatat Kosovës (Ligji nr. 03/L-223), Ligji për Prokurorin e Shtetit (Ligji nr. 03/L-225) dhe Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Ligji nr. 03/L-224).

³⁹ Neni 103, paragrafi 2 i Kushtetutës

Ligji nr 03/L-199 per Gjykatat, neni 9, Gjykata Themelore në territorin e Republikës së Kosovës. Neni 2. Shtatë (7) Gjykata Themelore themelohen si në vijim: 2.1. Gjykata Themelore e Prishtinës me seli në Prishtinë themelohet për territorin e Komunës së Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit, Lipjanit, Podujevës, Glllogovcit dhe të Graçanicës; 2.2. Gjykata Themelore e Gjilanit me seli në Gjilan themelohet për territorin e Komunës së Gjilanit, Kamenices, Novobërdës, Ranillugut, Parteshit, Vitisë, Kllokotit dhe Vërbocit; 2.3. Gjykata Themelore e Prizrenit me seli në Prizren themelohet për territorin e Komunës së Prizrenit, Dragashit, Suharekës dhe Mamushës; 2.4. Gjykata Themelore në Gjakovë me seli në Gjakovë themelohet për territorin e Komunës së Gjakovës, Malishevës, dhe Rahovecit;

2.5. Gjykata Themelore e Pejës me seli në Pejë themelohet për territorin e Komunës së Pejës, Deçanit, Junikut, Istogut dhe Klinës; 2.6. Gjykata Themelore e Ferizajit me seli në Ferizaj themelohet për territorin e Komunës së Ferizajit, Kaçanikut, Shtimes, Shtërpçës dhe Hanit të Elezit; 2.7. Gjykata Themelore e Mitrovicës me seli në Mitrovicë themelohet për territorin e Komunës së Mitrovicës ne Jug dhe Mitrovicës ne Veri, Laposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajit dhe Vushtrisë.

pozicioni i EULEX-it nga një trupë e përbashkët e përbërë nga ekspertë vendor, ekspertë nga Bashkimi Europian dhe OKB-ja lidhur me procedurat e ndjekura ligjore të rasteve konkrete dhe zhagritjen e tyre trajtimin e dosjeve të Zyrës së Prokurorisë së Posaçme të Kosovës që janë pranuar nga EULEX-I shkaqet dhe neglizhencën në procedimet e lëndëve të rënda penale ndjekjen penale të të gjithë atyre që kanë abuzuar me detyrën riformatimi i pozitës së EULEX-it në Kosovë dhe krijimi i kolegjeve të përbashkëta bazuar në ligjin e Prokurorisë Speciale të Kosovës për luftimin e krimeve të rënda i cili do gjykohej nga Gjykata Speciale verifikimin e të dhënave lidhur me korrupsionin brenda EULEX-it me qëllim të ruajtjes së kredibilitetit të misionit të kërkohet ndalimi i punësimit të prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe stafit tjetër udhëheqës të cilët kanë qenë në mision të UNMIK-ut apo të EULEX-it në institucionet private dhe publike në shtetet fqinje të Kosovës

Duke pasur parasysh misionin e përfunduar të UNMIK-ut cili ka ndihmuar në krijimin e Institucioneve të Kosovës, vendosjen e EULEX-it në Kosovë dhe autorizimet që ka Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar i BE-së në Kosovë, të kërkohet nga OKB-ja përfundimi i këtij misioni në Kosovë

T'i kërkohet BE-së ndërhyrja tek autoritetet e Serbisë me qëllim që të ndërpres çdo financim të aktiviteteve jo kushtuese paralele brenda dhe jashtë Kosovës dhe të kthehen të gjitha dokumentacionet publike të cilat janë nga Kosova dhe janë dërguar në Serbi

Të shikohet aplikimi i ligjeve sistimore në praktikë nga një komision i veçantë i Kuvendit të Kosovës

Në fushën administrative

Në fushën drejtësisë dhe të sigurisë

Në fushën e të drejtave të njeriut (arsimi, punësimi, prona)

Te evidentohen shkeljet dhe të nxirren rekomandimet për përgjegjësinë e zyrtarëve publik të të gjitha niveleve

Të përkrahët themelimi i Gjykatës Speciale me kohë të caktuar në Kosovë me qëllim që:

Të fillojë Dekriminalizimi i sistemit politik dhe juridik në Kosovë

Së pari, Kosovaret të rikthejnë besimin në sistemin e drejtësisë në Kosovë

Kosova të heq barrën e “fajësisë” “pa vendim gjykate” që po e përcjell nga e kaluara e saj jo e largët

Bibliografia

- Kushtetuta e KSAK (1974)
- Kushtetuta e ish-RSFJ (1974)
- Kushtetuta e Kaçanikut (7 shtator 1990)
- Rregullore Nr. 2001/9 Për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, 15 maj 2001
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës (09 prill 2008)
- Ligji i Procedurës Penale i ish-RSFJ, 1997
- Ligji Penal i KSAK (1977)
- Ligji mbi Gjykatat e Rregullta të KSAK (Gazeta Zyrtare KSAK nr.21/78 dhe 49/79), Prishtinë, 1979
- Ligji mbi Prokuroritë të KSAK 1978
- Ligji mbi Avokatinë Gazeta Zyrtare KSAK nr.19/77
- Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës UNMIK/RREG/2003/25 Gazeta zyrtare 6 korrik 2003
- Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës UNMIK/RREG/2003/26 Gazeta zyrtare 6 korrik 2003
- Kodi Nr. 04/L-082 Kodi Penal i Republikës së Kosovës
- Ligji Nr. 03/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës nr.2003/26
- Kodi Nr. 04/L-123 I Procedurës Penale
- Ligji nr.03/L-199 mbi Gjykatat, Ligji nr. 03/L-223 mbi Gjykatat,
- Ligji nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit
- Ligji nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës
- Ligji nr.03 /L-052 Për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës,
- Ligji Nr. 04/L -273 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Europian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës
- Zakon o sedistima i područjima Sudova i Javnih Tuzilastva Srbije,,Sl.glasnik RS”,br.101/2013
- Zakon o sedištima i područjima sudova i javnih tužilaštava (“Službeni glasnik RS”, br. 63/01 i 42/02) Zakon o sedištima I područjima sudova i javnih Tuzilastva Srbije,I(“Sl. glasnik RS”, br.116/2008) Ligji Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës
- Ligji Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës
- Ligji për Prokurorin e Shtetit (Ligji nr.03/L-225)
- Rezoluta 1244 e KS të OKB-së, 10 qershor 1999
- Rregullore nr.1999/1, Për Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë, 25 qershor 1999
- Rregullore nr.1999/6 Për Rekomandimet mbi strukturën dhe Administrimin e Shërbimit të Gjyqësisë dhe Prokurorisë, i datës 7 shtator 1999
- Rregullore nr. 1999/7 Për emërimin dhe shkarkimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve nga Detyra, i datës 7 shtator 1999 e ndryshuar me Rregulloren nr. 2000/57 i datës 6 tetor 2000

Haki Kabashi

Rregullore nr. 2000/13 i datës 31 maj 2000

Rregullore e UNMIK-ut nr. 2000/15, mbi krijimin e Departamentit të Administratës dhe Drejtësisë i datës 21 mars 2000

Rregullore nr. 1999/18 i datës 10 nëntor 1999

Rregullore nr. 1999/24, UNMIK/RREG/1999/24, Për Ligji në fuqi në Kosovë, 12 dhjetor 1999

Publikime

Bassiouni Cherif M. Introduction to International Law,
Transnational Publishers, Inc Ardsley, New York, fq.557

Dokumente

UN Security Council S Distr. General S/1999/779

Council Joint Action 2008/124 CFSP of 4 February 2008 on the EU role of Law Mission in Kosovo, Eulex Kosovo

Sporazum o saradnji SRJ i UNMIK-a u ponedeljak 5. novembra 2001 godine u Palati Federacije, Beograd

Të dhëna nga interneti

Dejtonski sporazum (ili Dejtonski mirovni sporazum ili Dejton <http://ndcsarajevo.org/Dokumenti/Dejtonski-mirovni-sporazum.pdf>,

Security Council Report, UN Documents for Kosovo <http://www.securitycouncilreport.org/un-documents/kosovo/>

Kosovo Today, Posted on 08 April 2014 Pos parë me datën 13.04.2015

INFO MAGAZINE KLANKOSOVA.tv **Published on Mar 28, 2014** parë me datën 13.04.2015

Deklarata e zëdhënësit të UNMIK-ut Aleksander Ivanko dhene RTK lajmet qendrore ora 19:30 i datës 23.01.2009

http://en.wikipedia.org/wiki/Kosovo_Vilayet#/media/File:Balkans_at_1905.jpg

Between 1922 and 1929, the Kingdom of Serbs, Croats and Slovenes was subdivided into 33 Oblasts shih <http://en.wikipedia.org/>

[wiki/Kingdom_of_Yugoslavia](http://en.wikipedia.org/wiki/Kingdom_of_Yugoslavia)

DISA NGA REFORMAT LEGJISLATIVE PËR PËRSHPEJTIMIN E INTEGRIMIT TË SHQIPERISË NË BE

IRISI MENGA

Doktorante/Fakulteti Juridik Universiteti Europian i Tiranës

ABSTRAKT

Shqipëria është një nga shtetet e cila inspiron për tu bërë pjesë e familjes së madhe europiane. Rruga për të arritur deri në anëtarësimin e Shqipërisë në BE është një rrugë e vështirë përballë sfidash të shumta dhe detyrash për tu përmbushur. Megjithatë proceset e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian kanë filluar dhe kjo vërtetohet me nënshkrimin e "Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit", e cila u nënshkrua me 12 qershor 2006 nga shteti Shqipëtar me Bashkimin Europian. Marrëveshja hyri në fuqi me 1 prill 2009. Por si do të vijojë procesi i integrimit të Shqipërisë në familjen e madhe europiane? Në këtë punim do të trajtoj disa nga reformat legjislative që duhet të ndërmarrë vendi ynë për përshpejtimin e integrimit evropian të Shqipërisë. Por cilat janë këto reforma që Shqipëria duhet të ndërmarrë? Disa nga reformat që duhet të ndërmarrë Shqipëria për anëtarësimin në BE janë: Një përafrim i legjislacionit tonë kombëtar me acquinë e BE-së; reforma në sistemin e drejtësisë; ndryshime kushtetuese si dhe disa reforma në administratën publike. Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Europian kushtëzohet me realizimin dhe zbatimin me sukses të një sërë reformash të gjëra dhe të thella në vend. Përmes tyre duhet të hidhen baza të qëndrueshme e të domosdoshme për të bërë transformime dhe ndryshime kushtetuese e ligjore, institucionale e strukturore, në pushtetin ekzekutiv e atë gjyqësorë të cilat mundësojnë respektimin sa më të mirë të parimeve të demokracisë dhe të shtetit të së drejtës si dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ndërmarrja e këtyre reformave nga institucionet e vendit tonë është një hap i rëndësishëm jo vetëm në planin e brendshëm por edhe në përshpejtimin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Fokusimi kryesor në këtë punim do të jetë kryesisht në disa reforma në administratën publike për përshpejtimin e integrimit të Shqipërisë në BE.

Fjalë kyç: *Integrim Evropian, Reformë Legjislative, Acqui, Marrëveshje e Stabilizimit Asocimit, Bashkim Evropian.*

Hyrje

Për një administratë publike të reformuar padyshim që qeveria duhet të jetë e përkushtuar për përafrimin e ligjeve me standardet e Bashkimit Evropian. Reformat në administratën publike ndikojnë jo vetëm në të mirë të shoqërisë por plotëson edhe një nga kushtet kryesore dhe ndoshta më të rëndësishme të integritimit sa me të shpejtë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Ky është një hap tepër i rëndësishëm në historinë e Shqipërisë. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit në 12 qershor 2006 ishte një moment shumë i rëndësishëm në procesin historik të Shqipërisë në rrugën e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit sjell edhe disa detyrime që shteti ynë duhet të përmbushë për integritimin në BE. Pavarësisht se vendi ynë ende nuk është bërë anëtarë me të drejta të plota të BE-së, direktivat (rregulloret) e miratuara prej tyre janë udhërrëfyese në reformimin e administratës publike. Duhet të ndërmerren hapa drejt procesit të harmonizimit dhe përafrimit të legjislacionit, duke synuar krijimin e një administrate publike efektive, të përgjegjshme dhe transparente që t'i paraprijë integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Nder kushtet themelore që Shqipëria të pranohet në “familjen e madhe” evropiane është përmirësimi i administratës publike, reformimi i sistemit administrativ, efikasiteti, produktiviteti, transparencja dhe përgjegjësi ndaj kërkesave të qytetarëve. Por që të kemi një administratë publike efektive, transparente, produktive duhet padyshim harmonizimi i normave kombëtare shqiptare me ato të BE-së.

Përafrimi i legjislacionit me AC-në e BE -së, kusht kryesor i integritimit të Shqipërisë në BE

Administrata Publike Shqiptare dhe reformimi i saj është një nga prioritetet kryesore të qeverisë dhe një nga kushtet për integritimin e Shqipërisë në BE. Përafrimi i legjislacionit tonë kombëtar me legjislacionin e BE-së përbën një nga kriteret e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Shqipëria duhet të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të përafrohen gradualisht me *acquis communautaire*, duke siguruar në të njëjtën kohë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe të vihet në zbatim në mënyrën e duhur.

Kjo do të thotë se një nga kushtet kryesore për integritimin e Shqipërisë në BE është aftësia e administratës publike për të miratuar dhe zbatuar legjislacionin e BE-së. Padyshim që përafrimi i legjislacionit kombëtar përbën një nga detyrimet më të rëndësishme të Shqipërisë në gjithë procesin e integritimit evropian.

Përafrimi i legjislacionit shqiptarë me atë evropian nuk duhet parë thjeshtë si një kërkesë nga pala komunitare kundrejt qeverisë së Shqiptare për të marrë masa për përafrimin e legjislacionit me AC e BE-se por si angazhim nga pala Shqiptare. Nga përafrimi i legjislacionit ky proces është thelbësorë për përfitimet që lejojnë marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë. Vlen të theksohet fakti, se dy sfidat kryesore me të cilat përballen të gjitha vendet kandidatë dhe potencial kandidatë në BE, janë përafrimi dhe zbatimi i legjislacionit komunitar. Shtetet që dëshirojnë të anëtarësohen duhet të plotësojnë tri kriteret e njohura si kriteret e Kopenhagenit:

Kriterin Politik, ku përfshihen stabiliteti i institucioneve që garantojnë demokraci.

Kriterin ekonomik, ku përfshihen ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale dhe kapacitet për të përballur presionin konkurrues dhe forcat e tregut Brenda e Bashkimit Evropian.

Pranimin e *acquis communautaire*, aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit duke përfshirë aderimin në synimet e bashkimit politik, ekonomik dhe monetar.

Referuar nenit 110 të MSA – se objektivat e qeverisë Shqiptarë për sa i përket reformës në administratën publike përfshijnë: Krijimin e një administrate transparente, të përgjegjshme, të hapur dhe koherente, forcimin institucional, sigurimin e procedurave të paanshme të rekrutimit, menaxhimit dhe burimeve njerëzore, zhvillimin e karrierës, trajnimet, promovimi i etikës në administratë publike etj. Por çfarë është bërë deri tani nga pala shqiptare dhe çfarë duhet bërë? Disa masa për përafrimin e legjislacionit Shqiptarë me standardet e BE-së janë marrë para nënshkrimit të MSA. Shqipëria e ka shumë të qartë rëndësinë e këtij procesi, kjo pasqyrohet edhe në një nga vendimet e Këshillit të Ministrave. Në VKM nr. 580 datë 10.09.2004 “Për fushën e aktivitetit të Ministrisë së Integritimit Evropian”³ jepet qartë përgjegjësia e Ministrisë së Integritimit Evropian e cila ka për mision drejtimin teknik dhe bashkërendimin e procesit të integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nëpërmjet përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian. Një rol shumë të rëndësishëm për këtë proces kanë ministratë dhe institucionet përkatëse për rishikimin e legjislacionit ekzistues lidhur me përputhshmërinë e legjislacionit tonë kombëtarë me atë të BE-së si dhe hartimin e legjislacionit të ri në përputhshmëri me *acquis communautaire*.

Synimi kryesor i përafrimit të legjislacionit gjatë gjithë periudhës 10 vjeçare është krijimi i kuadrit të nevojshëm ligjor dhe institucional, i cili do të krijonte mundësinë tregut shqiptar të integrohej gradualisht në tregun e brendshëm evropian.⁴ Megjithatë, theksojmë se praktika tregon se krahas arritjeve ka edhe mjaft probleme e vështirësi në drejtim të

Neni 70, pika 3 e MSA-se

Jus and Justicia nr. 4, Pranvera 2010/ UET/ PRESS

VKM nr 580 datë 10.09.2004 “Për fushën e aktivitetit të Ministrisë së Integritimit Evropian”, pika 1

Çështje të së drejtës administrative në vështrim krahasues, 2010, faqe 106

realizmit sa më mirë të kësaj detyre madhore që shtrihet i gjithë procesi i integritit. Vlen të përmendet fakti se një problem qendror mbetet mungesa e përvajtjes si dhe angazhimi dhe përgatitja e specialisteve me njohuri të plotë mbi të drejtën europiane.

Kjo për arsye se përzgjedhja e njerëzve të aftë si dhe përgatitja dhe kualifikimi i tyre në mënyrë të vazhdueshme në këtë drejtim janë mese të domosdoshme për ndjekjen në vijimësi të gjithë këtij procesi. Dhe pikërisht, në këtë kuadër, si vazhdim i logjikshëm të këtij procesi një rëndësi të veçantë paraqet evidentimi i dispozitave që kërkojnë zbatimin e parimeve themelore të legjislativës komunitare si ai i epërsisë së efektit të drejtpërdrejtë dhe proporcionalitetit.

Së fundi, theksojmë se i gjithë procesi i përafritimit të legjislativës kërkon bashkëpunim dhe koordinim të mirë dhe integral të këtyre mekanizmave për të bërë e mundur që vëmendja dhe energjitë kryesore të përqendrohen tek elementet më të rëndësishëm dhe esenciale të AC si dhe në detyrimet që burojnë në këtë drejtim nga marrëveshja e Asociimit Stabilizimit. Në këtë proces është e nevojshme të përfshihen patjetër përfaqësues të shoqërisë civile, specialist të fushës, grupet e interesit, shtesa e grupeve të ndryshme sociale etj. Në këtë mënyrë do të bëhet e mundur një përshtetje në mënyrë graduale, të natyrisht dhe të qëndrueshme sa i përket legjislativës shqiptare me AC.⁵

Reformat kryesore në procesin e integritit europian. Reformat në administratën publike

Për një administratë publike të reformuar padyshim që qeveria duhet të jetë e përkushtuar për përafritimin e ligjeve me standardet e BE-së. Nëpunësit publik zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit.⁶ Ky detyrim i nëpunësve që zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit, që caktohen me konkurs dhe që gëzojnë garanci të qëndrimit në detyrë, është detyrim kushtetues. Në shtator të 2009 qeveria e Shqipërisë ka miratuar “Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2009-2013”⁷ e cila synon rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të përgjithshme administrative në Shqipëri.

Shqipëria ka ratifikuar Marrëveshjen për Stabilizim Asociimit në BE dhe ky është një hap i rëndësishëm që vërteton përafritimin e Legjislativës tonë kombëtare me legjislativën e BE-së. Qeveria Shqiptare ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim Asociimit⁸ duke venë ndër prioritetet nevojën e rritjeve kapaciteteve administrative dhe financiare. Angazhimet që duhen angazhuar në kuadër të këtij plani janë: përmirësimi i legjislativës të shërbimit civil dhe zbatueshmëria e tij, përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucionet e administratës qendrore të përfshira në shërbimin civil për të siguruar procedura rekrutimi transparente dhe të paanshme si dhe zhvillimin e karrierës së nëpunësit civil, forcimin e administratës civile, sigurimi i strukturave efektive për realizimin e misioneve të tyre, motivimin e nëpunësit civil duke synuar në këtë mënyrë forcimin e qeverisjes. Marrja e statusit të vendit kandidat nga ana e Shqipërisë ka rritur përpjekjet dhe përgjegjësitë e palës Shqiptare për të realizuar me sukses dhe në kohën e duhur të gjitha kërkesat dhe standardet që kërkon anëtarësimi në Bashkimin Europian.

Për integritimin e Shqipërisë në BE duhet të ndërmerren disa reforma nga qeveria. Por cilat janë këto reforma? Padyshim që të gjitha strukturat shtetërore duhet të kontribuojnë në integritimin e vendit në BE por ky proces kërkon edhe krijimin e disa strukturave të veçanta dhe të specializuara. Institucionet e angazhuara në procesin e integritit mund të veçohen: Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Integritit. Ndërsa si institucione të krijuara rishtazi në funksion të këtij procesi mund të përmendim: Komiteti Ndërmintor për Integritimin Europian si dhe Komiteti i Koordinimit Ndërmintor për Integritimin Europian. Institucionet e krijuara në kuadër të MSA janë: Këshilli i Stabilizim Asociimit, Komiteti Parlamentar i Stabilizim Asociimit.⁹ Krijimi i gjykatave administrative është një hap shumë i rëndësishëm në mbarrëvajtjen e procedurave civile pasi tashme kemi një gjykim nga një gjykatë specifike. Krijimi i gjykatave administrative çon në një garantim më të mirë të të drejtës për akses në gjykatë, duke shmangur barrierat administrative burokratike në këtë drejtim. Normalisht se krijimi i gjykatës administrative sollti edhe një gjykim me të shpejtë.

Miratimi i ligjit të ri 152/2013 “Për nëpunësin civil” nga Kuvendi me 30 maj 2013 dhe botimi në fletoren zyrtare nr. 95, datë 7.06.2013, normalisht që përmirëson dhe forcon statusin e nëpunësit civil. Projekt vendimet në zbatim të ligjit “Për nëpunësin civil” propozojnë përcaktimin e procedurave të detajuara, që plotësojnë kuadrin ligjor dhe sigurojnë zbatimin e këtij ligji. Në procesin e hartimit të projekt vendimeve është treguar vëmendje e veçantë për të siguruar procedura transparente dhe në respektim të parimeve të përcaktuara në ligje, me qëllim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike.¹⁰

Konkluzionet

Komisioni Europian për Administratën publike thekson se kusht për Integritimin e Shqipërisë në BE është përmirësimi i gjendjes së administratës, reformimi i gjithë sistemit administrative. Në këtë punim paraqitet rëndësia që ka reformimi i administratës publike dhe përshtetja dhe harmonizimi i normave me legjislativën e BE së. Nënshkrimi i marrëveshjes së

⁵ Çështje të së drejtës administrative në vështrim krahasues, 2010, faqe 107

⁶ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 107/1)

⁷ VKM nr.1017 datë 18.9.2009 “Për miratimin e Strategjisë ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike”

⁸ Çështje të së drejtës administrative në vështrim krahasues, 2010, faqe 113

⁹ Çështje të së drejtës administrative në vështrim krahasues, 2010, faqe 103

¹⁰ www.dap.gov.al

stabilizim asociimit dëshmon në përgjegjësin që ka marrë pala Shqiptare për përafrimin e legjislacionit tonë kombëtare me legjislacionin e BE-së . Miratimi i ligjit të ri 152/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe krijimi i gjykatave administrative janë disa nga hapat e rëndësishëm që ka ndërmarrë vendi ynë për reformimin administrative.

Megjithatë mbeten edhe shumë reforma të tjera administrative për procesin e integritit të Shqipërisë sa me të shpejte në Bashkimin Europian, si, forcimin e kapaciteteve të Administratës Publike, sisteme efektive të menaxhimit, struktura organizative të përmirësuara, përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen publikut, rritjen e përgjegjshmërisë së nëpunësve publik por për rritjen e përgjegjshmërisë së nëpunësve civil mendoj që do të luante një rol shumë të madh ngritja e rrogave i cili është një faktor që do të ndikonte shumë në përgjegjshmërinë e nëpunësve si dhe në uljen e korrupsionit. Këto janë disa nga hapat që institucionet përkatëse duhet të ndërmarrin për në administratë publike të reformuar dhe të gatshme për rrugën e integritit të Shqipërisë në BE.

Bibliografia

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit,2006

Ligji “Për Nëpunësin Civil”

Zaganjori Xhezair, Çështje të së drejtës administrative në vështrim

krahasues,2010 Just and Justicia nr . 4 /UET/PRESS

VKM nr. 580 datë 10.09.2004 “ Për fushën e aktivitetit të Ministrisë së Integritit Evropian”

VKM nr. 1017 datë 18.09.2009 “Për miratimin e Strategjisë ndër sektoriale të Reformës në Administratën Publike”

www.dap.gov.al

IMPAKTI QË SOLLI KRIJIMI I MONEDHËS SË PËRBASHKËT EURO NË LËVIZJEN E LIRË TË KAPITALIT NË BE

DOKT. MAJLINDA TAJAJ

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti Juridik, Profili: E Drejtë Ndërkombëtare

Publike majlinda.tafaj@hotmail.com

ABSTRAKT

Futja e monedhës euro, në fillimet e saj pati një ndikim shumë të fortë në tregjet monetare jo vetëm në integrimin e tregut të përbashkët europian, por edhe në tregjet e monedhave botërore. Kështu, Euro-ja u përcaktua jo thjesht një krijim financiar, por edhe një perspektivë e thellë ekonomiko-politike dhe ndoshta një katalizator i madh i ndryshimeve në Europë. BEM ishte pikërisht një strategji me një objektivi për të prezantuar Euron si kurorëzimin me sukses të përpjekjeve shumëvjeçare për integrim. Bashkimi Ekonomik dhe Monetar me politikat e saj detyroi centralizimin e politikës monetare si dhe një sistem komunitar qendror për bankat qendrore kombëtare. BEM në vetvete përfaqësonte këmbeshmërinë e të gjitha monedhave të Komunitetit, pa lëkundje në normën e shkëmbimit të monedhave, duke i zëvendësuar me një monedhë të vetme të përbashkët e cila do të qarkullonte lirshëm në vendet e Unionit Europian.

Nga ana tjetër, faza e parë e Realizimit të BEM, (e cila do të arrihej në tre etapa) përkoi pikërisht me liberalizimin e plotë të lëvizjes së kapitalit dhe valutës e cila u vendos më 1 korrik 1999, mes shteteve anëtarë dhe vendeve të treta duke marrë kështu edhe karakter erga omnes. Ky liberalizim synonte të realizonte një bashkëpunim dhe një bashkërendim të politikave ekonomike dhe deri diku edhe politike në nivele të larta bankash qendrore ku plotësimi i kriterëve të konvergjençës ishte kusht paraprak për një shtet për të adaptuar monedhën e vetme. Por BEM dhe realizimi i tij në fazën e tretë sollën pasoja të rëndësishme në lidhje me strukturën institucionale, politikën ekonomike dhe politikën monetare duke pasur një ndikim të drejtpërsëdrejti në lëvizjen e lirë të kapitalit në BE. Natyrshëm lindin një sërë pyetjesh se: Cili ishte ky impakt dhe si ndikoi BEM në lëvizjen e lirë të kapitalit?

Fjalë kyç: Monedha euro, centralizim monetar, lëvizje e lirë e kapitalit, Bashkimi Ekonomik Monetar, BE.

E si mund të shprehet më mirë dëshira për një bashkim gjithnjë e më të ngushtë midis popujve të Europës sesa me anë të një monedhe që zëvendëson frangat e ndryshme, lirën apo markën gjermane. Një brez më vonë, popullsia që do të arrijë në moshë madhore nuk do të ketë njohur monedhë tjetër veç Euros. Në mënyrë të pashmangshme qytetarët e BE-së do të ndihen më afër njëri-tjetrit, me ndjesinë që i përkasin të njëjtit komunitet. Një monedhë e përbashkët kontribuon në zhvillimin e ndjesisë së një identitetit kolektiv të një përkatësie ndaj një komuniteti të vetëm. Që tani evropianët flasin për kombet pjesëmarrëse si një entitet i veçantë, të quajtur me emrin familjar Euroland.

Cohen.B.J, marrë në Revue d'ekonomie politikue, nr.20, 2003, Kaliforni,USA

1. Hyrje

Jo paqëllim e fillova këtë punim me këtë thënie të profesorit dhe ekonomistit të shquar Cohen, i cili përshkruan më së miri impaktin dhe kontributin që do sillte monedha e përbashkët *Euro*, në Bashkimin Europian, impakt jo vetëm ekonomik, por edhe impakt politik duke bërë të mundur arritjen e qëllimit final, krijimin e një Tregu të Përbashkët Europian ku do të qarkullonin lirshëm personat, mallrat, kapitalet dhe shërbimet e tjera. Një treg, i cili deri në ato momente kishte hasur një serë vështirësish dhe sfidash që kishte shqetësuar me të drejtë elitën europiane. Krijimi i Monedhës së përbashkët jo vetëm që do të rregullonte përfundimisht të gjitha problemet në fushën ekonomiko-monetare por do të afronte më shumë qytetarët e BE-së, duke ju dhënë ndjesinë e identitetit kolektiv. Por ky moment lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me një nga sukseset e padiskutueshme, realizimin me sukses të objektivit kryesor që ndërmori Unioni Europian(duke e vendosur atë edhe në kolonën komunitare), realizimin e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar (BEM). BEM u fut me traktatin e Mastritit dhe përbën etapën e fundit(faza e tretë) të integritimit ekonomik, nga ana tjetër krijimi i monedhës së vetme EURO dhe realizimi i tij përkoi pikërisht me liberalizimin e plotë të lëvizjes së kapitalit dhe valutës e cila u vendos më 1 korrik 1999 që ishte dhe faza më kulminante e Bashkimit. Ky liberalizim synonte të realizonte një bashkëpunim dhe një bashkërendim të politikave ekonomike dhe deri diku edhe politike në nivele të larta bankash qendrore ku plotësimi i kriterëve të konvergencës ishte kusht paraprak për një shtet për të adaptuar monedhën e vetme.

Bashkimi Ekonomik dhe Monetar BEM u fut me traktatin e Mastritit dhe përbën etapën e fundit të integritimit ekonomik, duke qenë se krijimi i monedhës së vetme do të lejonte që tregu të funksiononte realisht si një treg i brendshëm i unifikuar. Por BEM u Nën bazë të këtij traktati BEM do të funksiononte e mbështetur në dy politika kryesore,

E para: Politika Monetare, për të cilën shtete anëtarë ia kanë kaluar kompetencat Bashkimit me qëllim krijimin e një monedhe të përbashkët.

E dyta: Politika Ekonomike e cila do të mbetet kryesisht kompetencë e shteteve anëtarë duke pasur kështu vetëm një bashkërendim politikash kombëtare.

BEM do të detyronte centralizimin e politikës monetare, fiksimin e një sistemi komunitar për bankat qendrore komunitare, si dhe do mbështetej në prezumimin e normave fikse të shkëmbimit të monedhave, duke i zëvendësuar me një monedhë të vetme të përbashkët e cila do të qarkullonte lirshëm në vendet e Unionit Europian.

Nga ana tjetër, lëvizja e lirë e kapitalit ka qenë që në fillim një ndër objektivat e nenit 3 të Traktatit KE, si pjesë përbërëse e hartimit të tregut të përbashkët, sot tregu i brendshëm dhe pothuajse të gjitha liritë e tjera (si ajo e punëtorëve, shërbimeve dhe mallrave) varen nga liria e qarkullimit të kapitalit.⁴ Ndryshe nga liritë e tjera kjo liri qarkullimi është liberalizuar shumë më pjesërisht dhe gradualisht. Pasi edhe pse nuk mund të trajtohen si të njëjta me njëri-tjetrin, qarkullimi i lirë i kapitaleve ka humbur deri diku kuptimin me hyrjen në fuqi të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar dhe futjes së monedhës euro. BEM, (e cila do të arrihej në tre etapa), përkoi pikërisht me liberalizimin e plotë të lëvizjes së kapitalit dhe valutës e cila u vendos më 1 korrik 1999, mes shteteve anëtare dhe vendeve të treta duke marrë kështu edhe karakter *erga omnes*. Ky liberalizim synonte të realizonte një bashkëpunim dhe një bashkërendim të politikave ekonomike dhe deri diku edhe politike në nivele të larta bankash qendrore ku plotësimi i kriterëve të konvergencës (katër kritere), ishte kusht paraprak për një shtet për të adaptuar monedhën e vetme. Por BEM dhe realizimi i tij në fazën e tretë sollën pasoja të rëndësishme në lidhje me strukturën insitucionale, politikën ekonomike dhe politikën monetare duke pasur një ndikim të drejtpërsëdrejti në lëvizjen e lirë të kapitalit në BE ku në një hapësirë me lëvizje të gjerë të kapitalit, kurset e këmbimit tërhoqën goditje spekulative destabilizuese

BEM, solli edhe realizimin përfundimtar të Tregut të Përbashkët),

Prezantimi i monedhës Euro do të kalonte dy faza tranzitore, e para: ajo do të bashkëekzistonte me monedhat kombëtare periudhë që zgjati deri më 1 janar 2002. Faza e dytë: monedha do të kalonte një proces të qetë zëvendësimi që gradualisht në përfundim do të mbetëj në qarkullim monedha unike Euro

³ Tsoukalis, L. The Politics and Economics of European Monetary Integration. Allen & Unwin, London.,1977, fq 84. Plani Werner i vitit 1970 pati mbështetje politike nga niveli më i lartë pasi artikuloi qëllimin e Unionit Monetar Europian deri në vitin 1980. Kjo do të izolonte ekonominë Europiane nga lëvizjet e dollarit, të cilat ishin bërë shumë të paqëndrueshme.

Vet Gjykata GJKE e ka konfirmuar në një ndër vendimet e saj më të rëndësishme se, Liria e disa lëvizjeve të kapitaleve është praktikisht një nga kushtet e ushtrimit me efikasitet të lirive të tjera, të garantuara nga traktati siç është liria e vendosjes. GJKE 11 nëntor 1981, Casati, 203/80, REC. 2595.

si ajo e vitit 1992-93. BEM gjithashtu ishte i dobishëm sepse kurset e këmbimit me tepër se instrumentet e politikës, ishin bërë një burim i goditjeve asimetrike. Impakti që solli BEM dhe pasojat ligjore lidhen pikërisht me kalimin e fazës e tretë në këto struktura si më poshtë:

Në pasojat e strukturës institucionale: Faza e tretë lidhet me krijimin e Bankës Qendrore Europiane BQE^s, një institucion i pavarur në mbështetje të BEM, duke i deleguar asaj politikat monetare sidomos në përcaktimin e normës së interesit në zonën euro.

Në pasojat e strukturës së politikës monetare: BEM solli vendosjen e monedhës së përbashkët unike Euro. Në fazën e tretë Këshilli fiksoi normat e shkëmbimit për Shtetet Anëtare që hynin në monedhën e vetme. Impakti më i dallueshëm që solli monedha unike, përkoji pikërisht me kursimin e kostove të transaksioneve. Monedha e vetme hoqi koston e monedhave të shkëmbimit kur paraja lëviz brenda BE-së duke sjellë një përfitim kolosal në kursimet totale dhe duke ju dhënë fund abuzimeve dhe spekulimeve deri të atëhershme sidomos me kurset e këmbimit të valutave.

Në pasojat e politikës ekonomike: BEM shënoi zbatimin e shumë dispozitave të pakundërshtueshme të traktatit në lidhje më çështjet fiskale dhe buxhetore. Shtetet anëtare duhet të përpiqeshin ti shmangin detyrimet e tepërta të qeverisë, dhe jo vetëm ato duhej t'i shmangin me patjetër. Këshilli mori pushtet të plotë në fazën e tretë të BEM, për të marrë masa kundrejt shteteve që nuk zbatojnë rekomandimet e tij mbi deficitet e tepërta buxhetore.⁷

Impakti i Monedhës së përbashkët euro në politikën e jashtme të BE-së: Realizimi i monedhës unike Euro, paraqet suksesin e përpjekjeve të shumë dekadave për të bashkuar Europën, jo vetëm për arsye ekonomike, por dhe politike. Euro, është simboli i dukshëm i realizimit të bashkimit jo vetëm ekonomik por dhe atij politikë të shteteve anëtarë dhe jo anëtarë të BE-së, duke arritur kështu centralizimin e politikës monetare si dhe një sistem bankar komunitar qendror për bankat qendrore kombëtare. Rritja ekonomike është bazuar mbi një numër faktorësh si ai kursimit të kostove të transaksioneve dhe shteteve nuk iu duhet të mbajnë sisteme të ndryshme çmimesh në treg. Liberalizimi synonte të realizonte një bashkëpunim dhe një bashkërendim të politikave ekonomike dhe deri diku edhe politike në nivele të larta bankash qendrore ku plotësimi i kriterëve të konvergjençës, ishte kusht paraprak për një shtet për të adaptuar monedhën e vetme. Ekzistenca e një monedhe të vetme mbron kostot e lidhura me ndryshimet e mëdha të normave të shkëmbimit dhe zhvlerësimin konkurrues. Një treg unik do të kishte nevojë për një monedhë të vetme e përbashkët, pasi do të ndikonte shumë fortë në tregjet monetare jo vetëm në integrimin e tregut të përbashkët evropian, por edhe në tregjet ndërkombëtare.

2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij punimi është pikërisht i fokusuar në impaktin dhe pasojat ligjore që solli kalimi në fazën e tretë të BEM në lëvizjen e lirë të kapitaleve pas futjes së monedhës euro. Euro pati vërtet një hyrje shumë të fortë në botën e tregjeve të monedhave dhe transaksioneve jo vetëm brenda shteteve anëtarë por edhe jashtë kufijve të eurozonës duke ndikuar fuqishëm në lehtësimet dhe lëvizjet e kontrolluara të kapitaleve.⁸ Po kështu Euro ka sjellë pasojat për një varg politikash të komunitetit, si buxheti, bujqësia dhe tregu i brendshëm që u prekën direkt nga futja e kësaj monedhe.

Ndikimi i madh që pati BEM në politikën monetare përveç të tjerash rruga e vendosjes së një monedhe të vetme. Që në fillim të fazës së tretë Komisioni fiksoi normat e shkëmbimit për Shtete Anëtare që hynë në monedhën e vetme. Ishte ECU që zëvendësoi këto monedha në këtë normë duke u bërë një monedhë me të drejtë të plotë. Objektivat e politikës monetare të KE ishin të përcaktuara në nenin 105 TBE. Objektivi themelor i SEBQ⁹ ishte ruajtja dhe mbajtja në kontroll e stabilitetit të çmimeve përcaktuar në nenin 105 TBE. Po kështu SEBQ duhej të mbështeste politikat ekonomike të përgjithshme të Komunitetit me qëllim realizimin e qëllimeve të përcaktuara në nenin² duke vepruar në përputhje me parimin e ekonomisë së tregut të hapur dhe të konkurrencës së lirë. Në lidhje me lëvizjen e lirë të kapitaleve pasojat që solli kjo politike monetare ishin të favorshme dhe shumë frytdhënëse pasi SEBQ kishte si detyre baze të a) të përcaktojë dhe zbatojë politikën monetare të Komunitetit, b) të drejtojë veprimet e shkëmbimeve monetare të huaja, c) të mbajë dhe menaxhojë rezervat e huaja zyrtare të shteteve anëtare, d) të promovojë funksionin e mirë të sistemit të pagesave. Të gjithë këto komponentë përfshiheshin në gamën e gjerë që përfaqësonte kapitali në Eurozonë dhe jashtë saj. Vet BQE në fushën e saj të kompetencës duhet të konsultohet për çdo vendim të Komitetit dhe autoriteteve kombëtarë të caktuara lidhur me çdo projekt-dispozite ligjore.

⁵ Me krijimin e BQE shkrihet pararendësja e saj IME, BQE ka personalitet juridik dhe është institucion financiar supranacional dhe i pavarur. Në strukturën organizative ka një Bord Ekzekutiv dhe Këshill Drejtues. Bordi Ekzekutiv prbëhet nga Presidenti, Zëvendës President dhe katër antar që duhet të jenë ekspertë të njohur në çështjet monetare ose bankare. Pavarësia e BQE është përcaktuar në Nenin 108, i cili parashikon se në procesin e vendimarrjes është totalisht e pavarur nga cdo ndikim i Komunitetit apo të një shteti antar. BQE ka pushtet për të nxjerrë rregullore dhe vendime, rekomandime dhe opinione. Asaj i është dhënë e drejta të vendosë gjopa ose dënime periodike mbi ndermarrjet për mospërbushjen e detyrimeve të parashikuara në rregulloret dhe vendimet e saj.

Letessier. J & Silvano. J & Soïn. R.: Evropa ekonomike dhe e ardhmja e saj, Papirus, Tiranë 2009, fq. 93.

Po aty, fq 95.

Kontrollt kapitalit do të zbatohen në rastet e kufizimeve të vendosura në sasinë e aseteve të huaja që një qytetar i një shteti mund të këtë ligjërisht(ose asete domestike që mund të fitohen nga një i huaj).

SEBQ- Sistemi European I Bankave Qëndrore pararendëse e Komitetit Ekonomik dhe Financiar që u krijua me hyrjen e fazës së tretë të kalimit në BEM.

BQE ka të drejtën ekskluzive të lëshojë kartëmonedha brenda BE-së ndërsa SEBQ-ja jep orientim në drejtimin të politikave të ndjekura nga ana e autoriteteve kompetente lidhur me mbikëqyrjen e matur të institucioneve kredituese dhe stabilitetin e sistemit finaciar.¹⁰

Po kështu kalimi në fazën e tretë shënoi zbatimin e më shumë dispozitave të pakundërshtueshme të traktatit mbi politikën ekonomike të pakundërshtueshme të traktatit mbi politikën ekonomike, veçanërisht lidhur me çështjet fiskale dhe buxhetore ku qarkullimi i lirë i kapitaleve kishte hasur pengesë të vazhdueshme duke rënë pre e spekulimeve dhe keqinterpretimeve të ndryshme. BEM do të promovonte efikasitetin e tregut, stabilitetin e çmimeve, financat publike duke i dhënë BE-së avantazhet e lëshimit të një monedhe jo vetëm europiane por edhe ndërkombëtare. BEM ndihmoi në zhvillimin dhe konvergjencën e vendeve anëtarë më të varfëra përmes sinergjive nga programet kombëtare të zhvillimit, programit të tregut të vetëm duke shpalosur sloganin e Komisionit(1999),“një treg, një monedhë“. Po kështu, impakt pozitiv solli BEM, që më vonë do të njihet edhe si “Parajsa e shëndetshme“, për qeveritë të cilat ndiqnin inflacion të ulët dhe aftësi paguese fiskale. Institucionalizmi i BEM për politikën fiskale dhe buxhetore ku përbëheshin dhe përfaqësoheshin nga kapitali do të krijonte një rreth të virtytshëm në të gjitha çmimet stabilë dhe financat publike do të mundësonin norma interesi të ulëta, do të nxirrnin investime dhe do të drejt një rritjeje më të fortë.¹¹

3. BEM dhe Lëvizja e lirë e kapitalit, një retrospektivë historike.

Debati mbi BEM u ndikua nga ideja se Euro mund të konkurronte dollarin në gjirin e SMI¹²-së. Europeanët shihnin tek ajo mundësinë për të luajtur një rol më të rëndësishëm në ekonominë botërore, sidomos në raport me SHBA-në. Europa është në të njëjtin nivel ose më lart se SHBA për sa i përket prodhimit ose tregtisë ndërkombëtare, por jo për monedhën e saj. Hedhja në qarkullim e euros, përveçse një faktor integrimi për Europën, kishte ambicien e fshehtë të konkurronte dollarin amerikan. Funksionimi i Sistemit të Brenton Foods pati një karakter asimetrik për sa i përket përfitimit të SHBA-ve. Edhe pse sistemi në vetvete nuk është diskriminues, funksionimi i tij në një botë të dominuar nga epërsia ekonomike amerikane, çoi në përforsimin e pozitës së SHBA-së. Të gjendur para këtij rreziku shumë vende të industrializuara europiane njohën dificitet të mëdha tregtare dhe nevoja e marrjes së masave ishte e nevojshme dhe e menjëhershme që të funksionojë tregu i përbashkët.

Akti Unik Europian përbërë nga një seri amendamentesh parashikoi ndër të tjera vendosjen brenda datës 31 dhjetor 1992 të një hapësire pa kufij të brendshëm, në të cilën është siguruar qarkullimi i lirë i personave, mallrave, kapitaleve dhe shërbimeve të tjera: dhe se nuk përbante një angazhim për BEM. Hapja e tregut të madh Europian, e parashikuar nga ky traktat rivendosi në diskutim funksionimin e SME¹³-së. Rritja e lëvizjes së mallrave dhe kapitaleve midis vendeve nuk po përputhej shumë me ruajtjen e qëndrueshmërisë së kurseve të këmbimit. Dukej se po imponohej një integrim më i madh. Nga ana tjetër si rezultat i problemeve me ekonominë e SHBA-ve monedhat europiane filluan të lëkundeshin dhe të ndihej nevoja e marrjes së masave urgjente për parandalimin e mëtejshme të spekulimeve nga ana e agjenteve të shitjes(kampistëve), të disa monedhave të dobëta.¹⁴ Që në vitin 1969 Kryetarët e Shteteve europiane kishin vendosur që duhej të punohej për realizimin e një projekti BEM brenda afatit 10 vjeçar. Komisioni i drejtuar nga Ërner, kryeministri i Luksemburgut, kishin hedhë idetë e para se si do të funksiononte BEM. Ky projekt do të nënkuptonte ose këmbymërinë e të gjitha monedhave të Komunitetit, pa lëkundje në normën e shkëmbimit, ose që këto monedha mund të zëvendësohen nga një monedhë e vetme e Komunitetit. Ky raport gjithashtu vuri theksin se qëllimi i funksionimit të BEM do të detyronte centralizimin e politikës monetare, fiksimin e një sistemi komunitar për bankat qendrore komunitare, si dhe mbështetjen në prezumimin e normave fikse të shkëmbimit.¹⁵

Ky do të ishte një katalizator për fillimin e një sistemi sigurie për luhatjet e monedhave europiane, që do të merrte emrin *gjarpri monetar europian*¹⁶ cili vendosi parimin që diferenca ndërmjet normave të shkëmbimit të dy shteteve anëtarë nuk mund të jetë

Chang, M, “Integrimi Monetar në Bashkimin Europian”, Universum Press, Veternik, Prishtinë 2013, fq 48.

Po aty. Fq175.

IME-Instituti MonetarEuropian(IME)- Një institucion i përkohshëm i krijuar me 1 janar 1994 për të përmirësuar bashkpunimin në mes bankave qendrore dhe koordinimin e politikave monetare gjatë fazës së dytë të BEM dhe për tu përgatitur për monedhën unike Ky mekanizëm kontrollues është zëvendësuar nga BQE më 1 qershor 1998.

SME- 1979, Sistemi Monetar Europian pasrendëse e sistemit të gjarprit 1972 dhe përendëse e BEM. Përtej natyrës teknike qëllimi i tyre ishte të garantonin një barazi të qëndrueshme midis monedhave të vendeve antare nëpërmjet instrumentave detyrues. Një përpjekje e tillë e kështij instrumenti ishte ECU-ja, si (European Courrently Unit), që shërbente si njësi llogaritëse e përbashkët e përbërë nga një “grup eurosh”, ku vlera e secilës përcaktohej në bazë të kursit të monedhave të ndryshme, me saktë përcaktohej vlera e cdo monedhe të vecantë përkundrejt të gjitha monedhave të tjera kombtare. Këto vlera relevante u njohën si *norma qendrore bilaterale*. Cdo vend pjesëmarrës nuk mund të lejojë normen e tij të këmbimit të luhatet më shumë se 2.25% . Nëse ky limit kalohej me poshtë apo me lart kërkohej hyrja e bankave qendrore përkatëse.

Mobiliteti i kapitalit e bën kursin e këmbimit një burim jostabil për shkak të spekulimit valuator dhe prandaj nuk mund të përdoret si mjet i përshtatjes pas një goditje ekonomike. Unioni Monetar është i dëshirueshëm sepse largon një burim të rëndësishëm të goditjeve asimetrike dhe ruan kundër premimeve të rrezikut të këmbimit.

¹⁵ **Tsoukalis, L.** *The Politics and Economics of European Monetary Integration.* **Allen & Unëin**, London.,1977, fq 84. Plani Ërner i vitit 1970 pati mbështetje politike nga niveli më i lartë pasi artikuloi qëllimin e unionit monetar Europian deri në vitin 1980. Kjo do të izolonte ekonominë Europiane nga lëvizjet e dollarit, të cilat ishin bërë shumë të paqëndrueshme.

Gjarëpri Monetar Europian u ngrit si qëllim që të arrihej një zvogëlim i kufinjëve të luhatjes së monedhave europiane, duke hasur shumë vështirësi në ruajtjen e stabilitetit të vlerës së monedhaveve. Kjo sajese dhe përpjekje bashkëpunimi monetar kishte diçka shumë të lavdërueshme por pati një jetë shumë të vështirë në ruajtjen e monedhave europiane duke siguruar plotësisht vetëm qëndrueshmërinë e

me e madhe se se 2.25 %. I ravijëzuar në vitin 1972 me lindjen e gjarprit, integrimi monetar në Komunitetin Ekonomik Europian vazhdoi deri në vitin 1979 ku europianët u gjendën të detyruar nga dështimi gjarprit të parashikojnë ndërtimin e një sistemi të ri për të siguruar qëndrueshmërinë monetare me krijimin e Sistemit Monetar Europian (SME) pastaj me hapjen e një procesi që çoi në një monedhë të vetme.¹⁷ Kjo ide erdhi nga përfundimet e Komitetit të drejtuar nga presidenti i Komisionit të asaj kohe Zhak Delor, i cili hartoi një raport të mirë studiuar duke dhënë orientimet e duhura duke nxjerrë mësimet e duhura nga metoda komunitare e zbatuar deri në atë moment. Ky raport këshillonte vendosjen e BEM në tre etapa.¹⁸

Faza e parë ishte plotësimi i tregut të brendshëm, konvergencë ekonomike më e ngushtë dhe anëtarësim i të gjitha shteteve në MNK.

Faza e dytë fillonte me Sistemin Europian të Bankave Qendrore (SEBQ), detyra e saj do të ishte koordinimi i politikave monetare për Komunitetin.

Faza e tretë do të arrinte mbylljen e normave të shkëmbimit dhe lindjen e një monedhe të vetme të menaxhuar nga SEBQ me në krye Bankën Qendrore Europiane (BQE). Sipas këtij raporti duhej të këtë kontroll qendror mbi politikat fiskale të një shteti kur behej fjalë për lëvizjen e lirë të kapitaleve, veprimi i një shteti të caktuar mund të sjellë pasoja të dëmshme për inflacionin apo normat e interesit në të gjithë shtetet e tjera. Tashmë shtetet anëtarë kanë ngritur strukturat e tyre duke miratuar një linjë politike ekonomike dhe buxhetore të mbështetur mbi respektimin e kriterëve të konvergencës, të tilla si kufizimi i deficitit buxhetor (3% i PBB) dhe i huamarrjes (60% e PBB).¹⁹

Euro-ja u përcaktua jo thjesht një krijim financiar, por edhe një perspektivë e thellë ekonomiko-politike dhe ndoshta një katalizator i madh i ndryshimeve në Europë ajo hyri si monedha fiduciare duke zhdukur nga qarkullimi monedhat kombëtare dhe filloi të qarkullojë e vetme në territorin e 16 shteteve anëtare. Por realizimi i BEM nuk është një synim përfundimtar pasi ka përfshirë mjaft implikime të tjera duke marrë një vëmendje të veçantë në lidhje me politikën ekonomike të shteteve anëtarë e cila në bazë të nenit 99 KE konsiderohet si *interes i përbashkët* dhe supozon të bashkërenditur në kuadrin e Këshillit (një ilustrim i saj është *pakti i stabilitetit*²⁰ i cili përmendet rregullisht nga mediat).

4. Lëvizja e lirë e kapitaleve

Për sa i përket parimit kapital, parimi i lirisë së qarkullimit të kapitaleve ishte vendosur që në traktatin e Romës. Krijimi i tregut të përbashkët dhe për më tepër një tregu unik europian, nuk mund të konceptohej pa përmbylljen e një lirie themelore si ajo e qarkullimit të kapitaleve. Kjo liri është një ndër katër liritë themelore të vet funksionimit të një unioni të përbashkët si Bashkimi Europian, për më tepër ajo lidhet drejtpërsëdrejti me realizimin e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar. Nuk mund të realizohej ëndrra europiane pa liberalizuar krahas lirisë së tjerave (si ajo e personave, mallrave dhe shërbimeve) edhe lirinë e kapitaleve. Do të ishte e pamundur që të ushtroje këto liri nëse nuk do të ishte e mundur transferimi nga njëri shtet anëtar në tjetrin si p.sh., pagesat e punëtorëve, çmimet e mallrave dhe ato të shërbimeve..., etj.²¹

Traktati i Romës nuk kishte të sanksionuar asnjë detyrim formal për liberalizimin e lëvizjes së kapitalit. Neni 67 i këtij traktati trajtonte përcaktimin e masave të nevojshme për funksionimin normal të tregut të brendshëm. Periudha më pas nuk solli ndonjë ndryshim të madh në legjislacionin e komunitetit në lidhje me këtë liri, por direktivat të viteve 60-62 synonin kufizimet në lidhje me shkëmbimet valutore që në praktike ato nuk shënuan sukses në procesin e integritit të tregjeve kombëtare të kapitalit. Liberalizimi i kapitalit ka ndodhur gradualisht pasi kërkon të miratimin e një sërë direktivash, duke filluar nga masat e vitit 1960, asokohe si pjesë e programit të tregut të vetëm të viteve 1985-86 dhe së fundi në lidhje me futjen hap pas hapi të ekonomisë dhe bashkimit monetar BEM, nëpërmjet TBE-së (ish neni 73 i TKE).²²

atyre monedhave që i qëndruan besnike si, marka gjermane që u vlerësua kater here apo floririt holandez që u vlerësua dy here. Monedhat e tjera europiane patën luhajtje të theksuar. Ai nuk ishte një gjarpër por një korridor, ku monedhat takoheshin, përshëndeteshin dhe ndaheshin dhe problemi qëndronte në humbjen e sovranitetit monetare të disa shteteve europiane. Sistemi i kursit fiks të këmbimit kërkonte një valutë kryesore dhe pjesmarrësit duhej që të përcillnin lëvizjet e kësaj valute përndyshe valuta e tyre do të vuante spekulimet e tregjeve. Kështu të gjithë pjesëmarrësit, përveç gjermanisë sakrifikuuan sovranitetin monetar për të aderuar drejt kursit fiks të këmbimit. Kjo përpjekje dështoi në mënyrën më fatkeqe nën presionin e fakteve.

Jacoub.G, *Euro dhe Sistemi Monetar Europian*, Papirus, Tiranë, 2008, fq 57.

Nourissat.C, “*E Drejta e Biznesit e Bashkimit Europian*”, Bashkimi Ekonomik dhe Monetar, Papirus, Tiranë, fq 26-27.

Ibid fq 26.

Pakti i stabilitetit dhe i rritjes konsiston në sigurimin e vendeve antare që të mbajnë disiplinë buxhetore pas hyrjes së valutës së vetme. PSP është edhe impact parandalues edhe korrigjues. Shtetet janë të përkushtuara të mbajnë një buxhet të balancuar ose gati të balancuar (me një limit deficit 3%) shtete që nuk respektojnë rregullat potencialisht mund të futen procedurës së deficitit të tepërt e cila mund të rezultojë me një penalizim me gjobë.

Gjykata në një nga vendimet e saj më të rëndësishme ka citohur “ *liria e disa lëvizjeve të kapitaleve, ashtu si qarkullimi i lirë i personave dhe i shërbimeve, përbën njërin nga liritë themelore të Komunitetit*”, nënvizon si më poshtë “ *liria e disa lëvizjeve të kapitaleve është praktikisht një nga kushtet e ushtrimit me efikasitet të lirisë së tjerave, sic është liria e vendosjes*”. shih GJKE 11 nëntor 2011, Casati, 303/80, Rec. 2595. http://eurlex.europa.eu/smartapi/cgi/sga_doc?smartapi!celexplus!prod!CELEXnumdoc&numdoc=61989J0113&lg

Andreas, M & Gormely. L & Hadjiemmanuil. C, & Harden . I, “*Bashkimi Europian dhe Monetar*”, Sistemi Institucional, Kluëer, Oxford Press, 1997, fq 245.

Do të ishte marrëzi e vitit 1986, ku komisioni paraqiti planin e detajuar “*Program për liberalizimin e plotë të kapitalit*” ku jepeshin hollësi të planit të krijimit të një zone të vetme financiare europiane. Kërkohej unifikimi i tregjeve financiare, të qarkullimit të lirë të kapitalit dhe shkëmbimeve valutore. Parë në kontekstin e përgjithshëm duhej një revolucion brenda vet unionin europian i cili u konkretizua me hyrjen në fuqi të aktit unik europian që i dha me më fund të njëjtën rëndësi kësaj lirie në raport me liritë e tjera. Liberalizimi i plotë i kapitalit ndodhi plot një dekadë e gjysmë nga paraqitja e programit për të ndaluar të gjitha kufizimet në lëvizjen e kapitaleve brenda shteteve anëtare dhe shteteve anëtare me vendet e treta. Liberalizimi i plotë i kapitalit u vendos më 1 korrik 1990 me Direktivën n.361/88 dhe ka sanksionuar në mënyrë të përgjithshme parimin e lirisë së qarkullimit të kapitaleve dhe transfertave të valutave *tout court*, si mes shteteve anëtare dhe me vendet e treta duke marrë një karakter *erga omnes*.²³ Edhe në këtë lëvizje të lirë kufizimet do të viheshin në rastet përjashtimore të përcaktuara dhe vetëm pas një autorizimi special nga Komisioni. Kështu duke përfshirë hapjen e llogarive bankare, marrjen e kredive, transferimin e fondeve në mes shteteve anëtare dhe shteteve anëtare me shtetet e treta do të shkohej drejt një integrimi më të ngushtë ekonomik, ku lëvizja e lirë e kapitalit do të identifikohet me fazën e parë të Bashkimit ekonomik dhe Monetar.

Pasoja ligjore që solli kalimi në fazën e tretë BEM në lëvizjen e lirë të kapitalit.

Faza e tretë e BEM duhet të fillonte jo më vonë se 1 janari 1999. TBE përmbante kritere të detajuara në lidhje me kalimin e fazës së dytë tek faza e tretë, të cilat ishin të sanksionuar në nenin 121. Komisioni dhe IME ishin të ngarkuara të kontrollonin dhe të raportonin të Këshilli për progresin dhe hapat e bërë nga shtetet drejt BEM. Realizimet e kritereve të konvergencës dhe pavarësia institucionale e Bankave Qendrore të shteteve kontrolloheshin si parakusht për adaptimin e monedhës së vetme.²⁴ Dhe pikërisht në valën e gjithë kësaj lëvizjeje drejt fazës së tretë të BEM solli pasoja të rëndësishme në lidhje me strukturën institucionale, politikën monetare dhe politikën ekonomike duke ndikuar drejtpërsëdrejti në lehtësimet dhe qarkullimin e lirë të kapitaleve brenda dhe jashtë BE-së.

Në strukturën institucionale, pasoja ligjore që solli kalimi në fazën e tretë lidhet me krijimin e një institucioni supanacional të pavarur BQE, si një mekanizim kontrollues i sanksionuar tashmë në nenin 108, ku parashikohet shumë qartë që BQE nuk do të marrë asnjë udhëzim prej institucioneve të komunitetit, shteteve anëtare apo organizmi tjetër. Kjo pavarësi është pasqyruar edhe në strukturën vendimmarrëse të saj. Por fillimi i fazës së tretë BEM gjithashtu shënoi krijimin e Komunitetit Ekonomik dhe Financiar, të përbërë nga jo më shumë se dy anëtarë prej shteteve, nga Komisioni dhe BQE. Ky Komision mban në:

mbikëqyrje situatën ekonomike dhe financiare të shteteve anëtare dhe komunitetit,

kontrollon situatën e qarkullimit të lirë të kapitalit sidomos pas futjes së monedhës Euro, duke sjellë stabilitet të madh çmimesh përmes një inflacioni të ulët dhe duke rritur ndjeshëm ekonominë e eurozonës. Faktori më i dallueshëm është kursimi i kostove të transaksioneve sidomos në kuadrin e lëvizjes së lirë të kapitalit. Monedha e vetme arriti të mënjanonte koston e normave të shkëmbimit në qarkullimin e parasë brenda BE-së. Një përllogaritje e bërë nga Komisioni i BE-së rezultoi se kursimet totale që ishin arritur në sajë të kësaj mbikyrjeje dhe kontrolli kishin arritur një shifër rekord përafërsisht 25 miliard Euro duke ndikuar drejtpërsëdrejti në rritjen ekonomike të BE.²⁵

Pasoja më e rëndësishme ligjore e fazës së tretë lidhur me politikën monetare. Euro dhe impakti i saj në qarkullimin e lirë të kapitalit

Argumenti që BEM do të sillte rritje të madhe ekonomike dhe një impakt pozitiv në liberalizimin e plotë të kapitaleve me futjen e monedhës së vetme dhe të përbashkët mbështetet në një sërë faktorësh si p.sh faktori më i dallueshëm është kursimi i kostove të transaksioneve. Monedha e vetme hoqi koston e monedhave të shkëmbimit kur paraja lëviz brenda BE-së duke sjellë një përfitim kolossal në kursimet totale dhe duke ju dhënë fund abuzimeve dhe spekulimeve deri të atëhershme sidomos me kurset e këmbimit të valutave. Faktor tjetër i rëndësishëm është se ekzistenca dhe qarkullimi i një monedhe të vetme arrin të mbrojë koston e lidhura me ndryshimet e mëdha të normave të shkëmbimit dhe zhvlerësimit konkurrues. Tregut të vetëm i duhej një monedhë e vetme pasi lëkundjet e shpeshta të monedhave mund të ngadalësonin rritjen ekonomike duke krijuar pasiguri për bizneset dhe rreziku për mos të përthithur investime është i madh. Ekzistenca e diferencave të gjëra të çmimit, e ushqyer pjesërisht nga monedha të ndryshme, shërben gjithashtu për të ushqyer përpjekjet nga shtete anëtare në parandalimin e importeve paralele dhe për të ndaluar tregtinë brenda Komunitetit²⁶. Monedha e vetme do të ushqejë rritje nga ulja e normave të interesit dhe nxitja e investimeve. Duke pasur një monedhë të vetme bizneset kursejnë në mënyrën e kostove dhe nuk duhet të mbajnë sisteme të ndryshme çmimesh në treg.

Nga një këndvështrim i prodhuesit ky fakt lehtëson zhvillimin e strategjive të marketingut në Komunitet.

Nga këndvështrimi i konsumatorit mundëson krahasimin direkt të çmimeve për produktet në vendet të ndryshme.

Vendet nuk do të çojnë më normat e interesit mbi nivelet e përcaktuara dhe qarkullimi i kapitaleve kuadrin e investimeve direkt do të lehtësohet duke anashkaluar një sërë problemesh të shfaqura deri atëherë. Shumë kompani dhe investitorë të

Canaj. E & Bana. S. : E Drejta e Bashkimit Europian“, Lëvizja e lirë e kapitalit, Onufri, Tiranë 2014, fq 243.

²⁴ Barnard. R, & Dehousse. R “ The Loë of the Single European Market, Hard Publish, Oksford 2002, fq 198.

²⁵ Pelkmans ., J, “The Neë Approach to Technical Harmonization and Standardization”, 25 JCMS, 1987, fq249.

Sorensens. E, ”Abuse of right in Community Laë: A Principle of Substance or Merely Rhetoric”. CMLRLev 2006, fq 43

huaj nuk ishin të sigurt në xhirimet e kapitaleve të tyre kur kishin për të përfituar fitime të larta apo për të shlyer borxhin e shtrenjtë të huazuar në para si dhe kur kishin shpërndarjen e dividendëve. Qëndrimi në BEM dhe aplikimi i monedhës së përbashkët bazohet edhe në një argument të fortë si mbajtja e çmimeve të qëndrueshme dhe inflacion të ulët. Kursimtarët përfitojnë nga inflacioni i ulët meqenëse paratë e tyre ruajnë fuqinë blerëse të tyre për një kohë të gjatë. Inflacioni i latë e bën më të vështirë ruajtjen e planeve afatgjata të bizneseve dhe rishpërndan të ardhura në një mënyrë arbitrare.²⁷

Duke u mbështetur në të gjithë këtë që thamë me lartë qëndrimi në BEM ofron një mënyrë shumë të mirë me të qëndrueshme, më të mirë për uljen e inflacionit sidomos kur politika monetare drejtohet nga një bankë qendrore e pavarur, e cila nuk është subjekt i presioneve politike afatgjata duke ndikuar në qarkullimin e lirë dhe liberalizimin përfundimtar të kapitaleve në BE.

Konkluzione

Euro pati një ndikim shumë të fortë në tregjet monetare jo vetëm në integrimin e tregut të përbashkët europian, por edhe në tregjet e monedhave botërore por pati edhe rënie të konsiderueshme në lidhje me monedhat e tjera. Kështu, Euro-ja u përcaktua jo thjesht një krijim financiar, por edhe një perspektivë e thellë ekonomiko-politike dhe ndoshta një katalizator i madh i ndryshimeve në Europë. Kalimi në Euro ka pasur pasoja në një varg politikash të komunitetit, si buxheti, bujqësia dhe tregu i brendshëm, të gjitha këto janë veçanërisht të prekura nga futja e monedhës Euro, duke pasur impakt të fortë në liberalizimin e plote të kapitaleve dhe duke lehtësuar lëvizjen e lirë të tyre brenda BE-së.

BEM ishte pikërisht një strategji me një objektiv për të prezantuar Euron si kurorëzimin me sukses të përpjekjeve shumëvjeçare për integrimin ekonomiko-politik të BE-së. Bashkimi Ekonomik dhe Monetar me politikën e saj detyroi centralizimin e politikës monetare si dhe finalizoi themelimin e një sistemi të përbashkët komunitar qendror me krijimin e BQE, duke bërë tashmë të realizueshëm afrimin dhe bashkëpunimin e shteteve anëtare të BE-së jo vetëm në fushën ekonomike por edhe politike. BEM në vetvete përfaqëson këmbështimin e të gjitha monedhave të Komunitetit, pa lëkundje në normën e shkëmbimit të monedhave, duke i zëvendësuar me një monedhë të vetme të përbashkët e cila do të qarkullonte lirshëm në vendet e Unionit Europian. Edhe në këtë lëvizje të lirë kufizimet do të viheshin në rastet përjashtimore të përcaktuara dhe vetëm pas një autorizimi special nga Komisioni. Kështu duke përfshirë hapjen e llogarive bankare, marrjen e kredive, transferimin e fondeve në mes shteteve anëtare dhe shteteve anëtare me shtetet e treta do të shkohej drejt një integrimi më të ngushtë ekonomik, ku lëvizja e lirë e kapitalit u identifikua me fazën e parë të Bashkimit ekonomik dhe Monetar dhe realizimi i monedhës përkoi pikërisht me fazën e tretë të realizimit të BEM.

BEM dhe realizimi i sollën pasoja të rëndësishme ligjore në lidhje me strukturën institucionale me krijimin e një institucioni të pavarur BQE, politikën ekonomike në lidhje në çështjet fiskale buxhetore si dhe në politikën monetare me vendosjen dhe adaptimin e Monedhës së përbashkët Euro duke pasur një ndikim të drejtpërsëdrejti në lëvizjen e lirë të kapitalit në BE.

Bibliografi

- Andreas, M & Gormely. L & Hadjiemmanuil. C, & Harden . I, “*Bashkimi Europian dhe Monetar*“, Sistemi Institucional, Kluëer, Oxford Press, 1997.
- Barnard. R, & Dehousse. R “ The Loë of the Single European Market, Hard Publish, Oksford 2002.
- Chang. M, “Integrimi Monetar në Bashkimin Europian”, Universum Press, Veternik, Prishtinë 2013, Canaj. E & Bana. S, : E Drejta e Bashkimit Europian“, Lëvizja e lirë e kapitalit, Onufri, Tiranë 2014
- Tsoukalis, L. *The Politics and Economics of European Monetary Integration. Allen & Unëin*, London, 1977.
- Letessier. J & Silvano. J & Soin. R.: Evropa ekonomike dhe e ardhmja e saj, Papirus, Tiranë 2009.
- Nourissat. C, “*E Drejta e Biznesit e Bashkimit Europian*”, Bashkimi Ekonomik dhe Monetar, Papirous, Tiranë 2012.
- Barnard. R, & Dehousse. R “ The Loë of the Single European Market, Hard Publish, Oksford 2002.
- Pelkmans ., J, “The Neë Approach to Technical Harmonization and Standartdization”, 25 JCMS, 1987.
- Zajmi. I, “Tregu i Përbashkët Europian“, Lëvizja e lirë e kapitalit, Fakulteti Juridik i Tiranës, Tiranë 2009.

Burime intereneti

- <http://www.eurlex.europa.eu/>
<http://www.europa.eu> dhe
<http://www.mie.gov.al>

Zajmi. I, “Tregu i Përbashkët Europian“, Lëvizja e lirë e kapitalit, Fakulteti Juridik i Tiranës, Tirane 2009, fq167.

VEPRAT PENALE KUNDËR FËMIJËVE, FAMILJES DHE MARTESËS, NË PERIUDHËNEZHVILLIMEVETRANZITORE DEMOKRATIKE SHQIPTARE DHE PERSPEKTIVA EVROPIANE

MARILDA MENKSHI

Avokate (Dhoma Kombëtare e Avokatëve të Shqipërisë), doktorante në proces, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë nancy2mary@yahoo.com

MEDI BICI

Anëtar i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, doktorant në proces, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë medibici@yahoo.com

ABSTRAKT

Punimi ka për qëllim të pasqyrojë ndryshimet dhe risitë në legjislacionin penal shqiptar sa i përket veprave penale që lidhen me fëmijët, familjen edhe martesën gjatë periudhës së ndryshimeve demokratike shqiptare nga vitet 1990 e deri më sot. Një rëndësi të veçantë në këtë punim ka edhe identifikimi i legjislacionit evropian në lëmin penal lidhur me parashikimet dhe specifikat ligjore, sa i përket veprave penale që lidhen me familjen, fëmijët dhe martesën. Sa i është përafuar standardeve evropiane legjislacioni penal shqiptar, në sferën e veprave penale që lidhen me familjen, martesën dhe fëmijët. Praktika gjyqësore shqiptare lidhur me veprat penale kundër, fëmijëve, familjes dhe martesës, avancimi dhe përmirësimi i kësaj praktike si dhe sfidat e perspektivat e saj. Praktika ndërkombëtare dhe orientimi evropian drejt efikasitetit të legjislacioneve të implementuara rishtaz në vendet me demokraci në tranzicion.

Fjalë kyç: *dhuna në familje, trafikim i të miturve, keqtrajtim i të miturve.*

Hyrje

Legjislacioni shqiptar prej zhvillimeve demokratike dhe ndryshimit të regjimit ka pësuar ndryshime dhe përshtatje duke iu përafuar standardeve evropiane. Megjithatë një pjesë e ndryshimeve lidhen edhe me nevojat specifike të vendit tonë, në raport me marrëdhënie juridike që në raste të caktuara kanë kërkuar mbrojtje specifike edhe nga legjislacioni penal. Pavarësisht se në raste të caktuara kemi edhe parashikime veprash që janë specifike për Shqipërinë në raport me shtetet e tjera, nuk mund të themi se kemi parashikime ekstra dhe të shtuara me tepri, por çdo fakti e situatë konkrete i referohen edhe parashikime të tilla. Një vepër që ka tërhequr vëmendje edhe në nivel ndërkombëtar në kohë ka qenë dhe është edhe vepra e dhunimit të varreve parashikuar në Kodin Penal aktual në nenin 118 të K. Penal.

Megjithatë ajo që është fokus i këtij punimi janë veprat penale kundër martesës, fëmijëve dhe familjes. I jemi kushtuar këtyre grup veprimeve për analize, pasi ka një ndërhyrje të shpeshtë në Kodin Penal të periudhës post komuniste nga legjislatori. Ndërhyrjet e përmendura si më sipër do kenë një analizë të detajuar për të identifikuar nëse kanë qenë thjesht në kuadër të në standardizimi të legjislacionit penal shqiptar me atë ndërkombëtar e evropian apo nevojshmëri e ekzistencës së gjendjes së faktit e cila ka deduktuar edhe ndërhyrje në legjislacionin penal për të garantuar marrëdhënie juridike që cenoheshin nga veprime apo mosveprime kriminale.

Një këndvështrim të veçantë do të shihet në këtë punim edhe të drejtat e njeriut e praktika e gjykatës evropiane të Strasburgut në kuadër të mbrojtjes së familjes, martesës edhe fëmijëve . Kjo për faktin se këta tri element janë bazat e origjinës së një shteti, të një shoqërie dhe janë “druri i jetës” në nivel global të njerëzimit.

Tronditja dhe cenueshmëria e këtyre elementëve jetikë të shoqërive mbarë botërore nga veprime apo mosveprime kriminale dhe jo vetëm kërkon ndërhyrje nga organet e pushtetit dhe mbrojtje të veçantë. Këto janë edhe ndër principet bazë të pasqyruara, proklamuar por edhe të vendosura nën një vëmendje të veçantë në aktet ndërkombëtare si Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut¹, apo edhe kushtetutat e vendeve evropiane dhe ajo shqiptare².

Punimi do të trajtojë specifikisht ndryshimet në parashikimet penale që lidhen me këta element si dhe perspektivat e sfidat jo vetëm shqiptare në mbrojtje të këtyre elementëve të rëndësishëm për një shtet dhe për gjithë shoqëritë .

Parashikimet aktuale të veprave penale që lidhen me familjen, martesën dhe fëmijët, nevojshmëritë e shoqërisë shqiptare dhe përafritit me legjislacionin evropian e nevojshmërive globale

Në Kodin Penal aktual të azhornuar kemi seksionin e nëntë të cilësuar “Veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes”, të parashikuara brenda kreut të dytë “Vepra penale kundër personit”. Në tërësi, sistemi i veprave penale kundër personit në Kodin Penal është ndërtuar siç ishin në kodin e mëparshëm. Për shkak të rëndësisë të madhe që ka mbrojtja juridike penale e personit zënë vend fill pas krimeve kundër njerëzimit dhe janë ndërtuar sipas objektit grupor mbi baza shkencore. Në ndryshim nga kodi i shtetit diktatorial i vitit 1977 i cili i vendoste në kreun e katërt³. Karakteristika kryesore e legjislacionit penal të shteteve të huaja, sidomos të atyre që kanë dalë vitet e fundit, është sistemi i ndërtuar sipas kushteve e kërkesave të luftës ndaj kriminalitetit, në këtë apo atë vend, duke e pasuruar me krerë, seksione dhe dispozita të reja⁴. Të njëjtën gjë ka bërë edhe ligjvënësi shqiptar në përafritim e legjislacionit penal jo vetëm me atë evropian por edhe në përputhje me nevojat e vetë shoqërisë shqiptare.

Seksioni i nëntë i Kodit Penal aktual i kushton një rëndësi të veçantë mbrojtjes juridike penale të fëmijëve, martesës dhe familjes pasi është edhe një parim i rëndësishëm kushtetues. Kodi i mëparshëm penal i 1977 nuk parashikonte disa forma të tjera si braktisja e fëmijëve të mitur, mos njoftimi i ndryshimit të vendbanimit, marrja e padrejtë e fëmijës ndërrimi I fëmijës etj.⁵ Nëse i referohemi kuptimit të këtyre veprave duket të mbajmë parasysh se lidhen me veprime apo mosveprime të kundra ligjshme, shoqërisht të rrezikshme të kryera me faj, që cenojnë të drejtat e tyre të parashikuara edhe në aktin themelor të shtetit shqiptar Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, që parashikohen nga legjislacioni penal.

Braktisja e fëmijës së mitur është parashikuar për herë të parë me ndryshimet me ligjin nr. 8733 dt. 24.01.2001 të Kodit Penal ligji 7895 dt. 27.01.1995 . Pra kemi të bëjmë me ekzistencën e gjendjes së faktit që kërkon ndërhyrje edhe në legjislacionin penal për të shmangur sa më tepër këtë fenomen. Kjo lidhet edhe me lëvizjen e lirë të personave në një kohë që në periudhën e shtetit komunist edhe migrimi i brendshëm ishte i kontrolluar dhe individit ishte gjithmonë lehtësisht i identifikueshëm e jo më të mendohej realizimi i braktisjes së fëmijëve.

Po kështu edhe *Kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit* është një dispozitë e re⁷. Kjo vepër ka parasysh jo vetëm ardhjen e pasojave por përkundrazi pavarësisht pasojave mjafton që të përmbushet një nga tri elementët e anës objektive

Protokolli 7 amenduar me protokollin nr 11 Strasburg 22.11.1984 ku një vëmendje e posaçme i kushtohet bashkëshortëve dhe të drejtave të tyre por gjithnjë citohet interesi më i lartë i fëmijës. (neni 5)

Neni 53 pika 2 “Martesa dhe familja gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga shteti”.

I Elezi “E drejta Penale, pjesa e posaçme Tiranë 2005 fq 31.

I Elezi “E drejta Penale, pjesa e posaçme Tiranë 2005 fq 12.

I Elezi “E drejta Penale, pjesa e posaçme Tiranë 2005fq 164

Neni 124 I K.Penal aktual i azhornuar.

Ligj, Nr.9086, Dt.Aktit:19.06.2003, Dt.Miratimit:19.06.2003, Flet.Zyrtare Nr.57, Faqe:2432 Neni 5

dhe ajo konsiderohet e konsumuar. Nga ana tjetër duhet parë e lidhur edhe me procedurat e birësimit, pasi edhe kryerja ose moskryerja e një apo më shumë veprimeve që lidhen me procesin e birësimit duhet parë edhe në raport me ligjin e posaçëm nr. 9695 Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit dhe Kodin e Familjes.

Keqtrajtimi i të miturit është shtuar me ligjin nr.9859, datë 21.1.2008, neni 2 duke u parashikuar "Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga personi që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet". por që me kalimin e kohës janë bërë të nevojshme ndryshimet lidhur me këtë paragraf me ligjin, Nr.23/2012, Dt.Aktit:01.03.2012, Dt.Miratimit:01.03.2012, Flet. Zyrtare Nr.26, Faqe:1299, neni 16 "*Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor ose çdo person që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me burgim nga tre muaj gjer në dy vjet.*". Kjo ka lindur si nevojshmëri për një mbrojtje sa më efektive të fëmijëve edhe nga persona që nuk kam detyrim përkujdesje ndaj tij ligjërisht, por edhe për ata persona siç janë motra, vëllezër gjyshja apo gjyshi, të cilët kanë lidhje gjaku e marrëdhënie të drejtpërdrejta me fëmijën, por që ligjërisht nuk mbartin përgjegjësi apo detyrime specifike ligjore lidhur me mirërritjen apo edukimin e tyre. Sa i përket parashikimeve të paragrafit të dytë të kësaj veprë mbahen parasysh në përcaktimet e mësipërme edhe respektimin e akteve ndërkombëtare nga shteti shqiptar që lidhen me moshën e punës për fëmijët, apo mosshfrytëzimin e tyre, si Konventa 182 "Format më të këqija të punës së fëmijëve, 1999 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës"⁹, Konventa nr. 138 në lidhje me Moshën minimale për Pranimin në Punë e Organizatës Ndërkombëtare të Punës¹⁰. Patur parasysh këto dhe nevojat e shoqërisë shqiptare legjislatori me të drejtë ka bërë edhe një tjetër ndërhyrje në këtë nen me ligjin 144/2013¹¹ "*Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik, apo arsimimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.*".

Ndërsa vepra penale e *Mosdhënies së mjeteve për jetesë* parashikuar nga neni 125 I K. Penal Aktual nuk është një risi. Kjo vepër së bashku me veprat *Mos njoftimi i ndryshimit të vendbanimit* parashikuar nga neni 126 i Kodit Penal, *Marrja e padrejtë e fëmijëve* (neni 127), *Ndërrimi i fëmijëve* (neni 128), *Shtyrja e të miturve në krim* (neni 129), janë parashikime që nuk kanë pësuar ndryshime nga parashikimet e Kodit Penal të miratuar pas periudhës komuniste. Kjo edhe për faktin se kemi të bëjmë me vepra penale që lidhen me veprime apo mosveprime që janë pjesë e anës objektive të këtyre veprave të cilat nuk kanë ndonjë shfaqje apo formë tjetër gjatë periudhës së tranzicionit.

Neni 128/a *Fshehja ose ndërrimi me dashje i fëmijës* është shtuar në vitin 2001¹² që është një vepër penale e cila nuk mund të thuhet se konkurren me pengmarrjen pasi ka element specifik që lidhen me anën objektive që kërkon veprimet konkrete të ndërrimit ose të fshehjes së fëmijës dhe mund të kryhet me dashje direkte ose indirekte por që ka një rrezikshmëri më të ulët se ajo e pengmbajtjes po rrëmbimit.

Trafikimi i të miturve (neni 128/b) fillimisht është parashikuar në vitin 2001 dhe për një formulim më të saktë është rindërrur më ligjin nr. 9188 dt. 12.02.2004¹³. Në parashikimin e parë të kësaj veprë në Kodin Penal nuk janë shpjeguar element të anës objektive se si mund të kryhet trafikimi, kuptimi i tij. Ndërsa me ndryshimet e vitit 2004 janë parashikuar si veprime aktive edhe mosveprime të kundra ligjshme e shoqërisht të rrezikshme të kryera me faj në mënyra nga më të ndryshmet. Janë marrë tipike kuptimet dhe format e përdorura edhe në veprat e tjera penale si *Trafikimi i femrave apo personave* (neni 110/a apo 114/b). Me ndryshimet e 2004 është parashikuar edhe rastet e organizimit drejtimit apo financimi i trafikimit të të miturve duke e ngritur në një nivel më të lartë mbrojtjen e fëmijëve dhe luftën ndaj këtyre veprave kur vijnë në një trajtë më të sofistikuar. Ky nen ka pësuar edhe ndryshim në vitin 2008¹⁴ neni 3, duke u shtuar fjala *rekrutim* para fjalës *shitje* duke e plotësuar edhe me këtë element të anës objektive për shkak të konstatimeve se edhe kjo metodë përdorej për realizimin e trafikimit të fëmijëve. Kjo dispozite në kuptimin e anës objektive dhe parashikimeve të saj lidhur me këtë vepër në Kodin Penal është e plotë për sa i përket dënimeve të parashikuara në rastin kur pasojat e rënda mund të vijnë nga pakujdesia ka nevojë të diskutohen. Kjo për faktin se nëse pasojat do të vinin nga pakujdesia atëherë a mund të aplikohet burgimi i përgjeshëm? Unë do të mbështesja të njëjtën linjë edhe të studiuesve të tjerë se në rastin e aplikimit të burgimit të përgjeshëm ai nuk lidhet me veprime nga pakujdesia apo pasoja të ardhura prej saj por kur dëshirohen dhe ka vend për dashje direkte.

Shtërngimi ose pengimi për të bashkëjetuar apo për të zgjidhur martesë (neni 130) ka pësuar ndryshime nga parashikimi fillestar me ligjin 144/2013¹⁵ duke u shtuar paragrafi i dytë i cili parashikon edhe dënon edhe veprime të tilla si "*Kërkesa e qëllimshme ndaj një të rrituri ose fëmije për të shkuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim detyrimin e tij për të lidhur martesë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.*". Kjo për të siguruar që marrëdhënia martesore të jetë jo sa për sy e faqe, për ta garantuar me një mbrojtje të posaçme atë.

Një nga parashikimet më të rëndësishme është ai i nenit 130/a "*Dhuna në familje*" shtuar me ligjin 23/2012¹⁶ neni 17, ka një parashikim prej 3 paragrafesh dhe me ligjin 144/2013¹⁷ (neni 33) është shtuar dhe paragrafi i katërt i cili më tepër lidhet me rrethana të cilësuar të kryerjes së kësaj veprë dhe me parashikim dënimesh më të rënda në këto rrethana ngjarjeje.

Neni 124/b I K. Penal

Ligji nr 8774 dt 23.04.2001 fletore zyrtare 23, 18 MAJ 2001 fq 708

Përmbledhje e Legjislationit për Fëmijë në Republikën e Shqipërisë Tiranë 2012 botim I Qendrës për çështje të Informimit Publik. Fq. 49

Ligj, Nr. **144/2013**, Dt. Aktit: **02.05.2013**, Dt. Miratimit: **02.05.2013**, Flet. Zyrtare Nr. **83**, Faqe: **3526**

Ligj, Nr. **8733**, Dt. Aktit: **24.01.2001**, Dt. Miratimit: **24.01.2001**, Flet. Zyrtare Nr. **4**, Faqe: **100** Neni 35

Ligj, Nr. **9188**, Dt. Aktit: **12.02.2004**, Dt. Miratimit: **12.02.2004**, Flet. Zyrtare Nr. **13**, Faqe: **541**

Ligji 9859 21.01.2008

Ligj, Nr. **144/2013**, Dt. Aktit: **02.05.2013**, Dt. Miratimit: **02.05.2013**, Flet. Zyrtare Nr. **83**, Faqe: **3526**

Ligj, Nr. **23/2012**, Dt. Aktit: **01.03.2012**, Dt. Miratimit: **01.03.2012**, Flet. Zyrtare Nr. **26**, Faqe: **1299**

Ligj, Nr. **144/2013**, Dt. Aktit: **02.05.2013**, Dt. Miratimit: **02.05.2013**, Flet. Zyrtare Nr. **83**, Faqe: **3526**

Nevojshmëria e parashikimit të kësaj vepre në kodin penal lidhet me faktin pasi në shumë raste veprimet e kryera brenda familjes nuk mund të kategorizoheshin veçse në lëmin e veprave penale të thjeshta si kanosje, plagosje.

Praktika Gjyqësore Shqiptare dhe ajo Ndërkombëtare në kuadër të efikasitetit të legjislativës për një mbrojtje sa më të mirë të martesës, fëmijëve dhe familjes

Pas përfshirjes së një sërë veprave të reja penale në Kodin Penal shqiptar që lidhen me martesën, familjen dhe fëmijët edhe praktikuesit e së drejtës janë hasur me problematika nga më të ndryshmet. Nëse i referohemi edhe rasteve të veprës penale të parashikuar nga neni 130 i Kodit Penal *Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë* ka qene Gjykata e lartë që lidhur me subjektet para ndryshimeve të mëvonshme të këtij neni pas parashikimit të parë ka konkluduar se *...Në qoftë se ai, bashkëshorti, për të arritur qëllimin që të pengohet bashkëjetesa e përbashkët ose të zgjidhë lehtë martesën, bën kanosje apo i heq lirinë gruas ai do të përgjigjet për vepra të tjera penale sipas rastit por jo për kundravajtjen penale...*

Apo nëse i referohemi rasteve të procedimeve për dhunë në familje si vepër penale kur njëherësh është kërkuar për të njëjtat veprime edhe urdhri i menjëhershëm dhe ai i mbrojtjes, a duhet të vijojë gjykata me procedimin dhe gjykimin penal të çështjes? Nëse i referohemi praktikës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ¹⁸ është mbajtur qëndrimi se pavarësisht se kemi një shqyrtim të të njëjtave prova (në rastin konkret raporti mjeko ligjor, apo procesverbalet dhe aktet e tjera të marra në gjykimin e Urdhrit të Mbrojtjes), në gjykimin penal nuk mund të konsiderohet si gjë e gjykuar në një tjetër gjykim siç u pretendua. Kjo për faktin se gjykimi në rastin e Urdhrit të Mbrojtjes është për analogji ekuivalent me masën e sigurimit e cila përfshin edhe prova që do të gjykohen në themelin e çështjes por që nuk mund të përbejnë gjë të gjykuar. Gjithashtu duhet sqaruar se Urdhri i mbrojtjes nuk ka qëllim ndëshkimor por parandalues dhe mbrojtës i veçantë i individëve që janë përfshirë në të por kurrsesi nuk mund të ndalojë efektin ndëshkues dhe parandalimin e përgjithshëm për të garantuar me anë të ndëshkimit të autorit të veprës e mbrojtur shoqërinë në tërësi.

Nëse i referohemi edhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ka parashikime të posaçme sa i përket jetës familjare dhe praktika që lidhen me këto raste që detyrojnë shtetet që të respektojnë e garantojnë mbrojtje të veçantë familjes. Një kujdes serioz i është kushtuar edhe definicionit familje. Kjo lidhur edhe me statusin e nënave të pamartuara dhe fëmijëve të lindur jashtë martese, ku vetë Gjykata e Strasburgut ka qenë e kujdesshme në definimin e nenet 8 duke mos patur dallim mes fëmijëve me bazë martesën dhe asaj jashtë saj¹⁹. Detyrime këto që u implementuan edhe në legjislativën e shteteve evropiane për të mos e kufizuar nocionin familje vetëm me atë të prejardhur nga martesa. Pra ka qene edhe praktika ajo që ka orientuar legjislativën dhe aplikueshmërinë e tij.

Bibliografia dhe akte burimore

- Ismet Elezi, E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme Tiranë
- Mark Antoni Novicki, “Gurët Udhërrëfyes, Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut”, Ribotim i Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Tiranë 1996.
- Ledi Bianku “Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut“, ELDORA, Tiranë 2005.
- Legjislativi për Fëmijët në Republikën e Shqipërisë 1992-2012, Qendra Për Çështje të Informimit Publik, mbështetur nga UNICEF, Tiranë 2012.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf European Court of Human Rights Council of Europe F-67075
- Strasbourg codex www.echr.coe.int,
- Protokolli 7 amenduar me protokollin nr. 11 Strasburg 22.11.1984.
- Konventa Evropiane për Marrëdhëniet me Fëmijët, ratifikuar me ligj nr. 9359 dt. 24.03.2005 Fletore Zyrtare nr. 28 dt. 03.05.2005 fq. 1063.
- Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës botim UNICEF 1992.
- Ligj, Nr.9086, Dt.Aktit:19.06.2003, Dt.Miratimit:19.06.2003, Flet. Zyrtare Nr.57, Faqe:2432
- Ligji nr. 8774 dt. 23.04.2001 fletore zyrtare 23, 18 MAJ 2001 fq. 708
- Ligj, Nr.144/2013, Dt.Aktit:02.05.2013, Dt.Miratimit:02.05.2013, Flet. Zyrtare Nr.83, Faqe:3526
- Ligj, Nr.8733, Dt.Aktit:24.01.2001, Dt.Miratimit:24.01.2001, Flet. Zyrtare Nr.4, Faqe:100
- Ligj, Nr.9188, Dt.Aktit:12.02.2004, Dt.Miratimit:12.02.2004, Flet. Zyrtare Nr.13, Faqe:541
- Ligj, Nr.23/2012, Dt.Aktit:01.03.2012, Dt.Miratimit:01.03.2012, Flet. Zyrtare Nr.26, Faqe:1299

Çështja kundrejt të pandehurit A.Gjoni e vitit 2015

Mark Antoni Novicki, Gurët Udhërrëfyes, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut Tiranë 1996, Vendimi Marckx-I kundër Belgjikës 13 qershor 1979 A.31

TË DREJTAT E NJERIUT DHE EVOLUIMI I SOVRANITETIT TË SHETIT

PETRIT NIMANI PHD.C

Ligjërues në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti" dhe në Kolegjin "Biznesi"

ABSTRAKT

Evoluimi i pushteteve shtetërore nga sistemet autoritare, diktatoriale në demokraci ka bërë që të ndryshojnë edhe disa parime, të cilat ishin me një farë mënyre si statike rreth sovranitetit të shtetit. Pikërisht shekulli XX ishte vendimtar dhe u krijua një praktikë e re e cila bëri që këto parime statike të kohës të lëkunden dhe të ecet përpara në avancimin e të drejtave të njeriut, duke vlerësuar më shumë se asnjëherë më parë ato. Krijimi i Organizatave regjionale dhe atyre ndërkombëtare ishte një kapitull i ri në historinë e njerëzimit dhe shtetit. Organizata e Kombeve të Bashkuara ishte një kthesë e madhe për njerëzimin dhe për demokracinë në botë, pasi që u krijuan disa parakushte të cilat rezultuan të jenë të suksesshme në kufizimin e të drejtave të shtetit pikërisht në fushën më të rëndësishme siç është fusha e të drejtave të njeriut. Në punimin tonë ne do të mundohem që ta shpjegojmë hollësisht se si ka evoluar sovraniteti i shtetit që nga Paqja e Vestfalit e deri në ditët e sotme. Ne do të ngrinim shumë hipoteza dhe do të mundohem ti japim përgjigje çdo dileme rreth sovranitetit të shtetit dhe evoluimit në kohën moderne. Intervenimi Humanitar Ndërkombëtar është një shpikje e re e cila ndërroj rrjedhën e njerëzimit dhe filluan të trajtohen problemet në mënyrë më humane nga bashkësia ndërkombëtare. Në të kaluarën shtetet kishin të drejtën ekskluzive për trajtimin e të drejtave të njeriut duke u thirrur në sovranitet e tyre, ndërsa sot kemi mekanizma mbishtetërorë në gjykimin se si shtetet respektojnë të drejtat e qytetarëve të vetë. Ne do të ngrehim shumë dilema dhe pyetje rreth sovranitetit të shtetit. Cilët janë kufijtë e sovranitetit të shtetit? Pse njerëzimi u trondit si pasojë e keqpërdorimit të sovranitetit të shtetit nga shtete të caktuara? Cilat ishin pasojat që shkaktoi mungesa e një institucioni mbikombëtar? Sa ndikoi pozitivisht krijimi i Organizatave Mbikombëtare dhe Universale? Gjithashtu një çështje e cila nuk duhet injoruar është edhe globalizmi një çështje e cila është shumë aktuale dhe shumë e rëndësishme për shoqërinë. Këto dhe shumë çështje do të trajtojmë në punimin tonë shkencor.

Fjalë kyç: *sovraniteti i Shtetit, Intervenimi Humanitar Ndërkombëtar, Organizatat Ndërkombëtare (OKB, NATO, BE), Globalizmi, Demokracia etj.*

Themelet e Sovranitetit Shtetëror

Sovraniteti i shtetit daton shumë heret që nga viti 1517 kur Martin Lutern shkroi 95 tezat e tij në Wittenberg,¹ pastaj në vitin 1555 Paqja e Augsburgëve, Paqja në mes të Ferdit dhe Ligës Shmall Kall² dhe në vitin 1648 Paqja e Vestfalisë³, marrëveshje formale që u nënshkrua për përfundimin e luftës 30 vjeçare, njëkohësisht ky është gurrthemeli i konceptit të sovranitetit shtetëror.⁴

Sovraniteti për herë të parë, si term u formulua nga Zhan Bodin (Boudin 1530-1596), teoricien politik dhe këshilltar juridik i monarkisë franceze. Me fjalën sovranitet ai nënkuptonte autoritetin më të lartë (suprem) të qeverisjes së popullsisë dhe të ushtrimit të pushtetit sovran (të padiskutueshëm) si bazë themelore të çdo shteti. Një kuptim i tillë është në thelb të atij togfjalëshi që u quajt sovranitet i brendshëm.⁵

Në shek. XVIII, me Revolucionin Francez u pranua nocioni i sovranitetit të kombit

Nocioni evolvoi deri në kuptimin më modern të tij të bazuar në ligje dhe fakte reale, dhe njihet si sovraniteti ligjor. Më vonë, nocioni i sovranitetit të brendshëm u plotësua edhe me sovranitetin e jashtëm.⁶

Koncepti i shtetit është që t'i mbroj qytetarët dhe t'u ofroj siguri nga agresionet e jashtëme dhe të siguroj që aktivitetet ekonomike të vazhdojnë. Ky është koncept i Minimalistëve.

Koncepti me i gjerë thotë se shteti duhet të siguroj të mira për qytetarët siç janë: të drejtat e njeriut, edukimi dhe shëndetësia.⁷

Sovraniteti është njëri ndër elementet më të kontestuara të shtetit sepse që nga themelimi deri në ditët e sotme vazhdimisht ka qenë i atakuar nga veprimet e ndryshme të shteteve tjera dhe Organizatave Ndërkombëtare. Pra sovraniteti është i domosdoshëm për funksionimin e një shteti dhe vetëm sovraniteti e bënë një shtet të pavarur në aspektin e brendshëm dhe të jashtëm për veprimet e tij.

Në fillim në sistemet e vjetra karakterizoheshin me kompetenca të shumëta ku autoriteti ishte i përqendruar mbi perandorët dhe priferinjtë, fuqia e kohës kishte dominim në shoqëri dhe në politike, më vonë u zbehën dhe fuqia kaloi mbi politikën.

Dalja në sken e sistemit shtetëror ndodhi nga dy faktorë kryesor: kapitali dhe forca.⁸

Rritja ekonomike kishte nevojë për një burokraci qendrore që do të duhej t'i mblidhete taksat dhe kjo krijoi nevojën për krijimin e një force mbrojtëse siç është ushtria që mund të fuste në fuqi ligjet.⁹

Nga Paqja e Vestfalisë si gurëthemel i sovranitetit shtetëror dolën dy lloje të sovranitetit: Sovraniteti i jashtëm dhe sovraniteti i brendshëm, kështu i përshkruan Hdeley Bull¹⁰.

Sovraniteti i brendshëm është kapaciteti i autoriteteve shtetërore për të qeverisur brenda kufive të tij. Sovraniteti i jashtëm vjen nga njohjet apo nga mirëkuptimet nga shtetet tjera për të drejtën e pavarësisë dhe jo interferencës së një shteti tjetër.¹¹

Sovraniteti i jashtëm shërbente për përcaktimin e vendit të komb-shtetit, e mardhëniet me shtetet tjera, e pozicionit në arenën botërore dhe mbi të gjitha në ç' masë njihet dhe pranohet nga shtetet tjera dhe organizmat me karakter ndërkombëtar.

Encyclopedia- **Martin Luterni** me 31 tetor 1517 kishte publikuar në derën e Kishës Kalaja në Witenberg letrën me 95 tezat e tij. Luterni nuk ishte kundër Kishës por ai kundërshtonte Kishën por kundërshtonte praktikën shkencore që propagandonte Kisha. Kështu që ai vendosi ti publikoi 95 tezat e tij dhe këto teza u përhapën brenda një kohe të shkurtër në tërë Evropën dhe ato gjetën mbështetje.

Encyclopedia- **Paqja Augsburg dhe Liga Shmall Kall**, Paqja Augsburg ishte një Traktat midis Charles V dhe forcave të Ligës Shmall Kall – një aleancë e Princave Luternian. Me 25 shtator 1555 në qytetin perandorak Augsburg zyrtarisht përfundoi lufta fetare ndërmjet dy grupeve dhe u bë ndarja ligjore e Krishterizmit të përhershëm në kuadër të Perandorisë së Shenjët Romake. Paqja e vendosur mbi parimin **cuius regio, eius religio principle** (regjioni i kujt, feja e tij), i lejoi krerët e Selisë së Shenjët për të zgjedhur Luterianizmin ose Katolicizmin, u lejonte subjekteve, qytetarëve të cilët nuk pajtoheshin me zgjidhjen e princit të tyre u jepej një periudhë në të cilën ata ishin të lirë të emigrojnë në ajone të ndryshme në të cilat feja e tyre e dëshiruar ishte pranuar. Traktati i negociuar në emër të Charles's nga Ferdinand i vëllai i tij i dha statusin zyrtar Luternizmit brenda territoreve të Perandorisë së Shenjët Romake. Pra Paqja Augsburg ishte një bazë e përhershme ligjore për egzistencën e Luternianizmit, dhe përmes Traktatit të Paqes arritën marrëveshjen që Luternianizmi të egzistoj brenda Perandorisë së Shenjët Romake. Dhe këtu përfundoi lufta 50 vjeçare. Paqja Augsburg shpëtoi Perandoin nga konflikte serioze të brendshme për më shumë se 50 vjet. Ajo gjithashtu ka forcur fuqinë e sunduesit territorial. Bavaria (Gjermania) kishte dal nga shek. XVI si një vend i ndarë fetar.

Prof.Dr. Enver Hasani në librin e tij Vetvendosja, Integriteti territorial dhe stabiliteti ndërkombëtar: Rasti I Jugosllavis. fq – 57 **Paqja e Vestfalis 1648**, shënon pikën e nisjes për zhvillimin e sistemeve të shteteve moderne. Që nga kjo kohë e deri në revolucionet respektive amerikane dhe franceze, shoqëria ndërkombëtare u poq për të dal në fazën e shteteve kombe, ashtu siç i njohim sot. Në të njëjtën kohë, studiuesit përgaditën edhe kuadrin mendor të këtij tipi modern të vetëvendosjes. Ajo përfshinte jo vetëm konceptin e shtetit komb, por edhe sferën e të drejtave njerzore individuale. Vetëvendosja në këtë kohë ishte rrjedhojë logjike e këtyre dy aspekteve të veprimtarisë mendore, pra, e njohjes së të drejtave njerzore individuale dhe idesë mbi shtetin komb.

⁴ Hehir, Aidan. The Myth of the Failed State and the War on Terror: A Challenge to the Conventional Wisdom (2003) fq-186

Filo Llambro: Historia për sistemet e qeverisjes, Extra, Tiranë, 2003 fq - 16

Po aty fq- 16

Puto, Arben. E Drejta Ndërkombëtare Publike. Tiranë: Botimet Dudaj, 2010.fq-107

⁸ Hehir, Aidan. The Myth of the Failed State and the War on Terror: A Challenge to the Conventional Wisdom (2003) fq - 128

Richmond, Oliver P., and Jason Franks. Liberal Peace Transitions: Between Statebuilding and Peacebuilding. Edinburgh: Edinburgh UP, 2009. fq-341

www.britannica.com **Hdeley Bull** në vitin 1977 botoi veprën e tij Shoqëria Anarkike. Në këtë vepër Boll argumenton se: Pavarsisht nga karakteri anarkik në arenën ndërkombëtare ajo karakterizohet nga formimi i një sistemi jo vetëm të shteteve por një shoqëri të shteteve. Kërkesat e tij për një Etnitet të quajtur Shtet janë: se ato duhet të pretendojnë Sovranitetin mbi një grup të njerëzve në një territor të caktuar dhe se ai territor duhet të ketë një Qeveri. Sipas tij një sistem i shteteve mund të egzistoj pa qenë një shoqëri e shteteve.

Prof.Dr. Enver Hasani në librin e tij Vetvendosja, Integriteti territorial dhe stabiliteti ndërkombëtar: Rasti I Jugosllavis. fq - 59

Ky tip i sovranitetit njihet edhe si sovranitet kombëtar.¹²

Megjithatë Paqja e Vestfalisë sot nuk mund të shikohet si një dokument që garanton dhe siguron sovranitetin e jashtëm shtetëror sepse njohja e sovranitetit të jashtëm nga shtetet tjera atëherë do të nënkuptohej që nuk duhet të ketë ndërhyrje legjitime në aktivitetet e një shteti tjetër.

Por është fakt që nga viti 1648 deri në vitin 1815 numri i shteteve u zvogëlua, pasi që shtetet e mëdha i absorbonin shtetet e vogëla.¹³

Shekulli i XVIII dhe veçanërisht shekulli i XIX u karakterizuan me daljen e shteteve nacionale duke zbatuar principe cuius regio, eius regeio principe (regjioni i kujt, feja e tij), që nënkupton respektimin e teritorit të një populli, këto principe datojnë që nga Ausburgët në vitin 1555.¹⁴

Në fakt shtetet më të fuqishme europiane e injoruan në masë të madhe nocionin e vetëvendosjes dhe sovranitetit e pacenushmërisë territoriale, veçanërisht në kërkesat e tyre koloniale përmes okupimeve të egra e që nuk i'u referuan okupimit përmes Cedimit apo Terra Nullis.¹⁵

Në fund të shek. XVIII një numër i faktorëve ndikoi që nacionalizmi të bëhet një forcë në marrdhëniet ndërkombëtare si p.sh., ilimunizmi, zhvillimi i shtypit në shek.XVIII, Revolucioni Francez 1789 që ishte një kërkesë për të drejtën e popullit për të zgjedhur qeverinë e tyre dhe refuzimin e perandorive si njësi politike.¹⁶

Revolucioni Francez ishte një katalizator që mohonte iden e monarkut si një bartës kryesor i sovranitetit dhe favorizonin sovranitetin popullor. Nga ajo kohë shteti shihej si shërbëtor i popullit.

Ky ishte edhe një zhvillim tjetër apo një shfaqje e re e shteteve nacionaliste ku sovraniteti u bë qëllim kryesor i kombeve. Idea e Vetëvendosjes filloi të artikulohej nga Lufta e Parë Botërore të cilën e përkrahi edhe presidenti amerikan Wudrow Wilson.¹⁷

Wilson në vitin 1933 në Konferencën e Shtatë Internacionale të shteteve amerikane në Montevideo, SHBA-të u pajtuan që të mos ndërhyjë në punët e brendshme të shteteve Latino-Amerikane.

Konventa e Montevideos solli edhe një grup kriteresh për shtetësin të cilat u bënë standarde univverzale¹⁸. Neni 1 i konventës së Montevideos e vitit 1933 thotë që shtetet si persona të së drejtës ndërkombëtare duhet të kenë këto elemente: popullësin e përherëshme, b) teritorin e definuar, c) qeverin, d) kapacitete për të hyrë në marrdhënie me shtetet tjera¹⁹.

Këto elemente merren si bazë edhe në ditët e sotme për të njohur një shtet të ri, si shtet të pavarur dhe sovran.

Sipas të drejtës ndërkombëtare elementi kryesor i shtetit është sovraniteti, vërtet çdo shtet në gjendje normale duhet patjetër të ketë sovranitetin e plotë shtetërore që mund të jetë si palë në marrdhëniet ndërkombëtare.

Në të kaluarën jo të gjitha shtetet kishin sovranitet të plotë shtetëror në këtë grup të shteteve hynë: shtetet që kanë qenë nën suzeremin ose nën protektorat të ndonjë shteti tjetër, gjithashtu edhe shtete që bëjnë pjesë në federat nuk kanë sovranitet të plotë shtetëror.

Nga pikëpamja e shkallës së sovranitetit të tyre shpesh shtetet janë ndarë në shtete sovrane dhe gjysmësovrane, mirëpo ka autorë që e hedhin poshtë këtë ndarje të sovranitetit dhe thonë se shteti ose është sovran ose nuk është sovran.²⁰

Disa autorë e quajnë sovranitetin si një të keqe që është burim i të gjitha të kqijave në arenën ndërkombëtare, si „armiku i egër në paqen ndërkombëtare”, si „armiku i egër i paqes në kohën tonë”²¹.

Sovraniteti shtetëror tashmë është një çështje e debatueshme në komunitetin ndërkombëtar. Dihet rëndësia e sovranitetit shtetëror në krijimin e kushteve brenda një vendi, sipas gjykimit të qeverisë së atij vendi. Mirëpo, konfliktet e brendshme shkaktojnë po aq plagë dhe shkatërrime sa edhe konfliktet midis shteteve.

Mund të thuhet se luftërat civile sjellin më shumë vuajtje se luftërat ndërkombëtare, për shkak të urrejtjes dhe egërsisë së tyre. Kjo ndodh sepse në një luftë civile kundërshtarët e njohin mirë njëri-tjetrin.²²

Pikëpamjen më të skajshme për sovranitetin e ka shprehur autori amerikan M. Adler me këto fjalë, shkaku i vetëm i luftimeve është anarkia. Anarkia lind kudo që njerëzit apo kombet përipiqen të jetojnë së bashku, pa hequr dorë nga sovraniteti.

Filo Llambro: Historia për sistemet e qeverisjes, Extra, Tiranë, 2003 fq - 16

Puto, Arben. E Drejta Ndërkombëtare Publike. Tiranë: Botimet Dudaj, 2010.fq-127

¹⁴ Paris, Roland, and Timothy D. Sisk. The Dilemmas of Statebuilding: Confronting the Contradictions of Postwar Peace Operations. London: Routledge, 2009. fq-162

Gruda, Zejnullah, E drejta Ndërkombëtare Publike, Prishtinë, 2003. fq, 148; **Terra Nullis** është lloj I Okupimit paqësor dhe njihet në të drejtën ndërkombëtare që nënkuptohet si tokë e askujt dhe shtetet përmes marrveshjeve ndërkombëtare mund që ta marrin nënë sovranitetin e tyre këtë tokë. Mirëpo ky territor duhet të sigurohet që nuk është nën sovranitetin e asnjë shteti.

¹⁶ Hehir, Aidan. The Myth of the Failed State and the War on Terror: A Challenge to the Conventional Wisdom (2003) fq-253

Encyclopedia -**Woodrow Wilson** nga viti 1913 deri në vitin 1921 ishte President I SHBA-ve. Wilson në vitin 1919 mori çmimin Nobel për Paqe. Presidenti Wilson gëzon respekt të madh tek populli shqipëtar për rezistencën që bëri ndaj mos coptim të mëtejshëm të Shqipëris dhe njohjen e pavarësisë së saj. Ai ishte një Liberal dhe një kundështar I madh I luftës dhe kontriboi shumë në formimin e Lidhjes së Kombeve. Ai dha një kontribut në Traktatin e Varsajës duke kontribu në paqe me 14 pikat e tij të famëshme.

Gruda, Zejnullah, Manual Diplomatiq, Prishtinë, 2009, fq 30. **Konventa mbi të Drejtat dhe Detyrat e Shteteve (Montevideo, 1933)** e lidhur midis shteteve amerikane, në nenin 1 përcakton se shteti si subjekt I së drejtës ndërkombëtare duhet të ketë : a) Popullësin e përherëshme, b) teritorin e caktuar, c) qeverin, dhe ç) aftësin për të hyrë në marrdhënie me shtetet tjera. Këto kushte i kanë përmendur edhe Projekti i Institutit Amerikan i së Drejtës Ndërkombëtare (1926) dhe Projekti I Komisionit Interamerikan I Juristëve (1927).

Puto, Arben. E Drejta Ndërkombëtare Publike. Tiranë: Botimet Dudaj, 2010.fq-103

Puto, Arben. E Drejta Ndërkombëtare Publike. Tiranë: Botimet Dudaj, 2010 fq.106

Po aty, fq.108

Hans Peter Gasser, E drejta Ndërkombëtare Humanitare, Dhjetor 2000, f.26

Sovraniteti i kombit dhe anarkia janë dy gjëra të pandara, çmimi që paguhet për sovranitet është lufta.²³

Sovraniteti shtetëror daton që në kohëra të herëshme, mirëpo gjatë gjithë kohës sovraniteti pësoi ndryshime duke kaluar nëpër faza të ndryshme, si: Paqja e Augsburgëve, Revolucioni Borgjez Francez, Paqja e Vestfalisë dhe pikërisht kjo paqe vendos themelet e sovranitetit të shtetit modern. Në këtë drejtim ka kontribuar gjithashtu edhe Konventa e Montevideo-s duke percaktuar qartë elementet e shtetit, të cilat elemente edhe sot janë bazë për njohjen e një shteti të pavarur.

Sovraniteti është elementi kryesor i shtetit, një shtet në kushte normale duhet ta ushtron sovranitetin mbi territorin e vet pa asnjë ndërhyrje nga jashtë. Kohën e fundit e kam të paqartë se po ripercaktohet sovraniteti i shtetit nga faktor të ndryshëm si psh: të drejtat e njeriut, terrorizmi, globalizmi, zhvillimi ekonomik etj.

Vështirësitë e ruajtjes së sovranitetit shtetëror

Jemi dëshmitar të asaj se sot në botën moderne dhe në Rendin e ri Botëror dhe me zhvillimin e globalizmit, krijimit të Organizatave dhe institucioneve tjera ndërkombëtare, sovraniteti shtetëror po zbehet dita e ditës, sepse një pjesë e konsiderueshme e sovranitetit kalon nëpër intucionet apo në organizatat nërkombëtare.

Në këtë botë, konceptet stabilizuese të sovranitetit shtetëror, të unitetit territorial dhe të mos ndërhyrjes janë dëmtuar shumë, gjë që na le në një pozitë më pak të parashikueshme.

Një nga elementet më të rëndësishme të nocionit të sovranitetit është edhe sovraniteti territorial, që do të thotë se pushteti më i lartë dhe i pa ndarë i një shteti mbi territorin e tij. Çdo akt (i një anshë) që cenon pushtetin ekzekutiv të një shteti mbi territorin e tij, është një shkelje e së drejtës ndërkombëtare.²⁴

Parimi i sovranitetit territorial kërkon që asnjë shtet të mos tentoi të kryej akte juridiksioni në territorin e një shteti tjetër. Në këtë kuptim është shkelje e sovranitetit shtetëror nëse një shtet tenton që të dërgoi agjent në një shtet tjetër për kapjen apo arrestimin e ndonjë individi, i cili konsiderohet se ka kryer ndonjë veprë kriminale në shtetin tjetër.

Fundja, vetë identiteti i shtetit kombëtar - njësisë bërthamë të sistemit klasik, Vestfalez po sfidohet nga ato popullata etnike që nuk janë më të gatshme që t'i pranojnë kufijtë shtetëror të cilët i konsiderojnë të padrejtë.²⁵

Organizatave Ndërkombëtare përmes mekanizmave dhe legjislacionit në fuqi mund të obligojnë shtetet dhe institucionet shtetërore që të sillen sipas të drejtës ndërkombëtare dhe në raport me rezolutat dhe Kartën e OKB-së pasi që me nënshkrimin e Kartës së OKB-së e drejta ndërkombëtare është në eperësi ndaj të drejtës së brendëshme dhe se shtetet janë të obliguara t'i zbatojnë këto dokumente që dalin nga vendet anëtare demokratike të këtyre Organizatave.

Kuptohet që çdo shtet ka të drejtë të zgjedh vetë, në mënyrë të pavarur, qështjen nëse duhet apo jo të hyjë në organizata ndërkombëtare apo të hyjë në marrveshje ndërkombëtare me shtete tjera.

Secili shtet është sovran në zgjidhjen e kësaj qështje, mirëpo me hyrjen e shtetit në këto instanca ndërkombëtare për shtetin krijohen detyra dhe përgjegjësi, ku shteti nuk mund t'i shmanget këtyre përgjegjësi. Shkelja ose heqja dorë nga detyrimet që ka marrë një shtet në arenën ndërkombëtare, nuk mund të justifikohet me pretekstin e sovranitetit të tij.

Sovraniteti nuk duhet të nënkuptohet në asnjë mënyrë nuk do të thotë të cenohen normat e së drejtës ndërkombëtare e as të merren nëpër këmbë interesat e të tjerëve.²⁶

Meqenëse shteti është akter kryesor në politikën ndërkombëtare, atëherë duhet të

krijohet një frym bashkëpunimi në mes shteteve dhe në raport me organizatat ndërkombëtare në mënyrë që të jenë më të përgjegjshme ndaj veprimeve të tyre e mos të fshihen pas sovranitetit shtetëror në veprimet e tyre kundër ligjore.

Rastet me të shpeshta të fshehjes pas sovranitetit ndodh tek federatat ku njësit federative nuk i japin llogari bashkësisë ndërkombëtare por federata është ajo që në mënyrë të pavarur përfaqëson apo bart sovranitetin e shteteve përbërëse.²⁷

E drejta e Sovranitetit si e drejtë absolute, ka qenë e përkrahur rregullisht nga shtetet imperialiste me qëllim që të shërbej si arsytim për veprimet e tyre që kanë në kundërshtim me normat e së drejtës ndërkombëtare dhe të një rendi ndërkombëtar dhe objektivisht ka hapur mundësinë e mohimit të së drejtës ndërkombëtare dhe një rendi ndërkombëtar.²⁸

Sovraniteti paraqitet si fenomen i së kaluarës, i cili e ka humbur vlerën në ditët e sotme me krijimin e organizatave ndërkombëtare, me shtimin e konsiderueshëm të lidhjeve midis popujve dhe të vendeve me shtimin e ndërvarësisë shteteve, kjo është e diskutueshme nëse sovraniteti është pengesë kryesore për një rend më human në botë. Këto raste në të cilat shpërthyen në vitet 1990 protesta më e madhe morale, gjenocidit të Ruandës në vitin 1994 dhe masakrën në Srebrenicë në

M. Adler: *Ordering International Politics: Identity, Crisis and Representational Force*. fq. 287

Puto, Arben. *E Drejta Ndërkombëtare Publike*. Tiranë: Botimet Dudaj, 2010 fq - 107

Weller, Marc: *Shtetësia e Kontestuar: Administrimi Ndërkombëtar i Luftës së Kosovës Për Pavarësi*. Prishtinë: Përktheu nga origjinali anglisht Flaka Suroi, Koha, 2009 fq- 204

²⁶ Hehir, Aidan. *The Myth of the Failed State and the War on Terror: A Challenge to the Conventional Wisdom* (2003) fq - 179

Gruda, Zejnullah: *E drejta Ndërkombëtare Publike*, Prishtinë, 2009, fq. 124, Hell, A,W: *Tratise on International Law*, Salihu, Kurtsh: *E Drejta Kushtetuse*, Prishtinë, 2004. **Federata** është trajtë e shtetit të përbër e cila paraqet një lidhje shumë më të ngushtë nërmjet shteteve. Federata është bashkësi e më shumë njësive (shteteve, vendeve) dhe krijohet me akt publik të brendëshëm. (Kushtetut). Federata të tilla kemi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u krijuan si federat me kushtetutën e vitit 1787. Bashkimi Sovjetik u krijua si federat në dhjetor të vitit 1922, Zvicra është federat nga viti 1848, gjithashtu ishte edhe ish Republika Socialiste Federative e Jugosllavis ku pjesë përbërse e saj ishte edhe Kosova. Karakteristik të Federatave është se pjesët përbërëse të fëdërates bartin një pjesë të sovranitetit ndërsa përfaqësimin e jashtëm dhe Sovranitetin në aspektin ndërkombëtar e bartë federata.

²⁸ Hehir, Aidan. *The Myth of the Failed State and the War on Terror: A Challenge to the Conventional Wisdom* (2003) fq - 186

vitin 1995, çoi shumë të bëjë thirrje për një ndryshim në statusin e sovranitetit. Është e paqartë, megjithatë, se çfarë ndikojnë sovranitetin ushtrohet në të dyja këto raste.

Bën thirrje për një zvogëlimi të sovranitetit në dritën e këtyre incidenteve, do të kishte kuptim vetëm nëse aktorët e jashtëm nuk kanë ndërhyrë, sepse ata nuk duan të thyejnë ligjin ndërkombëtar.

Kjo, megjithatë, nuk ishte rasti. Reagimi i paefektshëm i bashkësisë ndërkombëtare për të dyja rastet që rrjedhin ndoshta nga mungesa e interesit dhe vullnetit në emër të atyre me kapacitet për të ndërhyrë sesa ndonjë angazhim në drejtën ndërkombëtare.

Kodifikimin e barazisë sovrane dhe paprekshmërinë në Kartën e OKB-së ka qenë duke konceptuar si një zhvillim progresiv për aq sa ajo përbënte një mjet me të cilin të drejtat më parë pothuajse ekskluzivisht janë gëzuar nga fuqitë perëndimore.

Ndryshimet e Sovranitetit Shtetëror në kohën moderne

Me zhvillimin dhe krijimin e organizatave ndërkombëtare dhe regjionale, sovraniteti i shtetit po bartet në këto organizata dhe se këto organizata kanë qasje mbi shtetin dhe luajnë një rol jashtëzakonisht të madh dhe të rëndësishëm në sovranitetin e shteteve.

Ishin disa faktorë relevant që ndikuan në përcaktimin dhe ndryshimin e sovranitetit të shtetit në kohën moderne siç janë: të drejtat e njeriut, zhillimi ekonomik dhe terrorizmi, faktorë të cilët ndikuan që sovraniteti shtetëror të pësojë ndryshime thelbësor në kohën moderne.

Sovraniteti shtetëror është me interes të madh për studiuesit e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe është subjekt i diskutimeve të shumta. Natyra e tij është vendosur në zemër të sistemit gjeo-politik. Natyra e sovranitetit shtetëror ka ndryshuar në periudhën pas Luftës së Ftohtë për të pasqyruar një shoqërie në ndryshim global dhe se kjo është për të mirën e politikës globale dhe qytetarëve.²⁹

Në vitet e 90-ta ishim dëshmitarë të një debati të fuqishëm për kuptimin e fjalës sovranitet.

Aktorët ndërkombëtar përfshirë Sekretarin e OKB-së si dhe disa qeveri dhe institucione ndërkombëtare si Këshilli i Sigurimit i OKB-së të cilët ishin protagonist kryesor të një debati i cili përfshinte autorizimin e Këshillit të Sigurimit për përdorimin e forcës së armatosur në disa raste ku popullsia vuante shumë nga mizorit e shteteve të tyre.³⁰

Së fundi globalizimi edhe pse ka ndryshuar natyrën e sovranitetit shtetëror pas Luftës së Ftohtë, duke u fokusuar në lëvizje nga një statisticien në sistemin policentrik të qeverisjes globale dhe ndikimin gërryes se kjo ka pasur në konceptet tradicionale të sovranitetit të shtetit në çështjet financiare dhe ushtarake. Duke bërë kështu që të theksojë se sovranitetin shtetëror ka ndryshuar me të vërtetë në periudhën pas Luftës së Ftohtë dhe se ky ndryshim ka provuar të jetë pozitiv.

Jemi dëshmitar të kohës se e drejta ndërkombëtare ka evoluar dhe sot jemi në një situatë të re, por nuk jemi ithtar të asaj se duhet të braktisim diskursin e sovranitetit në mënyrë që të perceptojnë dhe konceptojnë këto ndryshime që po ndodhin çdo ditë.

Mund të devijonim natyrën bashkëkohore ndërkombëtare dhe shoqërinë politike, në qoftë se ne supozojmë se një e drejtë kushtetuese me qëllime kozmopolite ligjore³¹ tashmë ekziston, e cila ka zëvendësuar ose duhet zëvendësuar të drejtën ndërkombëtare dhe parimet e saj kryesore të barazisë sovrane, territoriale, integritetit dhe mosndërhyrjes si dhe juridiksionin e brendshëm, nëse ne interpretojmë doktrinën në zhvillim “Ndërhyrja humanitare” si zbatim i kësaj të drejte, do të jemi në rrezik duke bërë rolin e perandorëve për projekte perandorake.

Argumenti kryesor që ne sot përballemi ndaj një zgjidhje është se: ne ose mund të zgjedhim për të forcuar të drejtën ndërkombëtare duke e rifreskuar atë, duke e bërë eksplicite konceptin e sovranitetit mbi të cilin është bazuar dhe tani duke treguar se kjo është në përputhje me parimet e kozmopolit të natyrshëm dhe të drejtat e njeriut, ose ne mund të braktisim parimin e barazisë sovrane dhe rregullat aktuale të së drejtës ndërkombëtare për hir të drejtave të njeriut, duke hequr dorë nga një pengesë e rëndësishme në përhapjen e projekteve perandorake dhe përpjekjet rajonale.³²

Shoqëria është e pengulitur brenda institucioneve ndërkombëtare dhe drejtandërkombëtare, të cilat kanë gji hashturëndësinë e elementeve kozmopolite dhe parimeve ligjore mbi të cilat mbështetet diskursi i transnationalizmit dhe qeverisjes demokratike. Kjo qasje e kozmopolit ligjor është e ndërlikuar potencialisht nga një projekt radikal i dallueshëm nga perandori dhe fuqia, deri tek demokratizimi i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe implementimi në praktik i të drejtës ndërkombëtare bashkëkohore. Kjo kërkon forcimin e institucioneve mbikombëtare, reforma ligjore formale dhe krijimin e një rregullative globale e ligjore që mbron si sovranitetin dhe barazinë e shteteve në bazë të një rishikimi të konceptit të

Krasner, Stephen.D. Sovereignty Organised Hypocrisy. : Princeton UP, 1999 fq. 142

Weller, Marc:Shtetësia e Kontestuar: Administrimi Ndërkombëtar i Luftës së Kosovës Për Pavarësi. Prishtinë: Përktheu nga origjinali anglisht Flaka Suroi, Koha, 2009, fq- 206

Encyclopedia **Kazmopolitanizmi** është ideologji që deklaroi se I gjithë njerëzimi I takon një komuniteti të vetëm, mundësisht duke u bauer në vlerat morale të përbashkëta. Komopolitanizmi është në kontrast me teorit komunitare, në veçanti me ideologjit e patriotizmit dhe nacionalizmit. Kozmopolitanizmi mund të imponoj llojet e qeverive globale apo ajo mund vetëm t'i referohet marrëdhënieve morale, ekonomike, dhe politike midis shteteve apo individëve me kombësi të ndryshme. Kozmopolitizmi është teori borgjeze reaksionare, që përpiqet të shuaj veçorit e ndjenjat kombëtare, duke quajtur për atëdhe gjoja gjithë botën, duke përçmuar vlerat e mëdha të kulturave e të traditave kombëtare dhe duke u mohuar popujve të drejtën për të jetuar të lirë e të pavarur në emër gjoja të,,bashkësis së njerëzve të gjithë botës”, të shtetit,,botëror”, me qëllim që të përllig nënshtrimin e sundimin e popujve.

Hehir, Aidan. Humanitarian Intervention after Kosovo: Iraq, Darfur and the Record of Global Civil Society Hardcover, 2008 fq -162

sovranitetit dhe të drejtave të njeriut. Sipas teorianëve ligjor, drejtësia pa sovranitet shtetëror është paradoksi për reformimin dhe demokratizimin e sovranitetit të brendshëm dhe të jashtëm, të cilët kanë konfiguruar brenda një bote efektive institucionet ndërkombëtare dhe të një të drejtë të përditësuar ndërkombëtare, për lindjen e një “sundimi të ligjit” global dhe përbën një pjesë të rëndësishme të një projekti për perandori gjithë botërore të një sistemi.³³ Pa një rregull globale që mbron sovranitetin, si dhe të drejtat e njeriut, çdo diskutim për të drejtën e “kozmpolit”, veçanërisht dhe mbi të drejtën e supozuar për të ndërhyrë ushtarakisht për të mbrojtur të drejtat e njeriut, është e natyrshme të dyshojmë.

Për Schmitt³⁴ dhe pasuesit e tij bashkëkohore, çdo version të së drejtës ndërkombëtare artikulumit universal, parimet, dhe çdo formë të mundshme kozmopolitizmit, shuma për formalizëm të zbrazët, utopizmit të papërgjegjshme, dhe një grup i platurës moraliste cinike përdoret që t’i mbulojnë ofertat, fuqinë e një superfuqie ose të një fuqie të madhe kundër disa të dobëta.

Kemi dëgjuar për shumë kohë se sovraniteti shtetëror është jo i rëndësishëm, karakteri ndërkombëtar i “rreziqeve”, nga problemet ekologjike deri tek terrorizmi, përfshirë dhe armët e shkatërrimit masiv, thekson mungesën e dukshme të kontrollit të kombit modern mbi territorin e vet, kufijtë dhe rreziqet që ballafaqohen qytetarët e tij.

Për më tepër, vendimet kryesore politike dhe ligjore janë duke u bërë përtej fushëveprimit të legjislativave kombëtare. Një shumëllojshmëri rrjetesh organizatash mbikombëtare, transnacionale “Autoritete globale private” dhe trans-shtetërore janë duke u angazhuar në rregullimin dhe zbatimin e bërë duke anashkaluar shtetin.³⁵

Vërtetë shkëputja e dukshme e ligjit nga territorialiteti i shtetit sugjeron se kjo e fundit ka humbur anën ligjore të saj, si dhe sovranitetin politik. Ky rregull risi i së drejtës ka nxitur daljen nga një grup i kërkesave në lidhje me transformimin e së drejtës ndërkombëtare. Nëse ligji po shmanget nga monopoli i shteteve, atëherë pamjet standarde të drejtës ndërkombëtare si ligj që shtetet bëjnë nëpërmjet traktateve, ose miratimi përmes praktikës së gjatë (custom), atëherë duhet të rishikohet sistemi ndërkombëtar i të drejtës. Shfaqja e të drejtave të njeriut bazohet në konsensus dhe me sa duket kjo nënkupton ligjin global kozmopolitan të vullnetit të shteteve dhe të traktateve të tyre ndërkombëtare. Teoricienët ligjor janë shtuar në kohën e fundit për t’u përballur me sfidat që sot preokupohet njerëzimi dhe shtetet. Idetë për pluralizëm ligjor dhe kushtetues, konstitucionalizmi shoqëror-social, rrjetet transnacionale qeveritare, kozmopolitizmi i të drejtave të njeriut zbatohen nga ndërhyrja humanitare dhe kështu me radhë janë të gjitha përpjekjet për të kuptuar rendin e ri botëror ligjor që është duke u shfaqur para syve tonë. Ideja e përgjithshme është se bota po përjeton një lëvizje të ligjit kozmopolit, të cilit ne nuk do të i kuptojmë ose s’do jemi në gjendje për të ndikuar në to, në qoftë se ne nuk braktisim diskursin e vjetruar dhe tashmë të pazbatueshëm të sovranitetit shtetëror. Debatet nga ky këndvështrim janë rreth kuptimit të rendit të ri botëror. Pavarësisht dallimeve të tyre, ajo që duket e qartë për ata që kërkojnë të ndihmojnë kozmopolitizmin ligjor është se bisedat rreth sovranitetit dhe format e vjetra të drejtës ndërkombëtare publike bazohen në paradigmen e sovranitetit Vestfalian dhe të të gjitha ligjet ndërkombëtare.

Cenimi i Sovranitetit Shtetëror si pasojë e Intervenimeve Humanitare

Koha po e dëshmon se është shumë e nevojshme dhe imediate që të ripërcaktohet funksioni i sovranitetit shtetëror duke pasqyruar se me zhvillimin e demokracisë, bashkësia ndërkombëtare ka filluar të ndërgjegjësohet dhe të drejtat e njeriut t’i ketë primare dhe të garantoj ato në çdo shtet dhe në çdo kohë, ku në rastet e fundit është dëshmuar se është një gardian i mbrojtjes së tyre.

Përderisa shtete të ndryshme fshiheshin pas sovranitetit të tyre, në ditët e sotme ka filluar që kjo fshehje pas petkut të sovranitetit të zbehet, sepse bashkësia ndërkombëtare dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare janë bërë ruajtëse të paqes dhe sigurisë globale, duke i kushtuar një rëndësi të madhe të drejtave dhe lirive të njeriut.³⁶

Intervenimi Humanitar përkufizohet rregullisht si përzjerje e dhunëshme në punët e shtetit tjetër, me qëllim që të ruhet ose të ndërrohet gjendja ekzistuese.

Gjithashtu ekziston edhe parimi i mos-intervenimit që mbështetet në parimin e sovranitetit dhe të vetëvendosjes të cilat janë përgjithsisht të pranuar në të drejtën ndërkombëtare, por këto parime të sovranitetit nuk mund të shërbejnë më si mbrojtje nga jashtë dhe kjo mund të rrezikojë në qoftë se shtetet nuk përmirësojnë veprimet dhe trajtimin ç’njëzëror ndaj qytetarëve të vet.

Sipas të drejtës ndërkombëtare çdo popull dhe çdo shtet ka të drejtë ta bëjë rregullimin e brendshëm pa presionin e asnjë shteti tjetër por me kusht që t’i respektojnë parimet dhe normat që dalin nga e drejta ndërkombëtare si dhe rezolutat e organizatave ndërkombëtare.

Shtetet mund të caktojnë dhe ta përmirësojnë statusin e vet politik, ekonomik dhe ideologjik, lirisht dhe pa kurrëfar presioni ose përdorimi të forcës nga shtetet e tjera.

Krasner, Stephen.D. Sovereignty Organised Hypocrisy. : Princeton UP, 1999

www.stahlshmidt-inc.com Oliver Jan Shmitt lindi në Basel më 15 shkurt 1973. Është anëtar i Akademisë së Shkencave Austriake. Shmit shkroi për Skënderbeun dhe bëri një biografi kritike rreth jetës së tij.

Kuqi, Hajredin and Bilalli, Asllan: E Drejta Ndërkombëtare Private: Prishtinë, 2009 **Autoritete globale private** janë kompani ndërkombëtare që fushëveprimtaria e tyre shtrihet në shumë shtete dhe janë ndikues të mëdhenjë në politikën e shteteve si dhe të organizatave ndërkombëtare. Rastin e fundit kem Britaninë e Madhe e cila paralajmëoi tërheqjen nga Bashkimi Evropian dhe bizneset dhe kompanit menjëher reagon kundër kësaj ideje.

Hans Peter Gasser, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, “ E drejta ndërkombëtare humanitare”, Ed. Pedone, dhjetor 2000, f.q. 127

Ndërsa sipas disa autorëve të cilët ende edhe në ditët e sotme mbrojnë qëndrimin e tyre se sovraniteti i shtetit është i paprekshëm dhe sipas tyre çdo veprim, me të cilin cenohet parimi i sovranitetit dhe i vetëvendosjes është veprim që bie në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare dhe si i tillë është dhe merret si keqpërdorim i forcës.³⁷

Ata ende nuk po mund të pajtohen se e drejta ndërkombëtare duke përfshi edhe sovranitetin shtetëror ka pësuar ndryshime pas intervenimeve humanitare dhe pas zhvillimit ekonomik dhe të drejtave të njeriut që detyrimisht kanë marr një karakter ndërkombëtar.

Intervenimi Humanitar ishte zgjidhja e vetëme për të penguar mizorit shkatërrimtare të diktatorëve dhe pamundësimin e arritjes së qëllimeve të tyre që të qëndrojnë në pushtet duke i shtyp paknaqësit e njerëzve.

Një rritje e shpejtë në ndërhyrjen humanitare dhe ndikimi i saj mbi sovranitetin shtetëror, duke përfshirë lëvizje larg nga nocioni realist i sovranitetit shtetëror në një pozicion gjithnjë e më moral e nxitur nga një lëvizje në rritje globale të shoqërisë civile si dhe një përkushtim dhe një siguri të ofruar nga NATO³⁸ siç ishte rasti i intervenimit në Kosovë dhe së fundi në Libi, dëshmuar edhe njëherë se të drejtat e njeriut kishin një trajtim të veçantë nga bota demokratike.

Ishin të neveritshme ngjarjet që ndodhën në këto vende prandaj u desh që të gjendet një bazë ligjore, të parandalohen këto mizori, dhe të krijohet një bazë ligjore e cila do të shërbej edhe për rastet e tjera si dhe do të jetë një vetëdijësim për shtetet me sisteme autoritare.

Shtetet sovraane ligjërisht janë të barabarta-”aktorë” në skenën ndërkombëtare, duke mos pranuar asnjë autoritet, brenda dhe jashtë. Shtetet kanë të drejtën e vetëmbrojtjes dhe atë të mosndërhyrjes nga shtetet e tjera sipas autorit Brown. Ai citon se është i gabuar supozimi se natyra e sovranitetit shtetëror nuk ka ndryshuar me kalimin e kohës, por atributet kryesore të Paqes së Vestfalisë duhet të mbeten po aq të rëndësishme edhe sot, duke pas parasysh se janë të kodifikuara në kuadër të Kartës së Kombeve të Bashkuara, neni 2 (1) duke deklaruar se “Organizimi është i bazuar në parimin e barazisë sovraane të të gjithë anëtarëve të tij “(Kombet e Bashkuara).

Qëllimi i krijimit të organizatave ndërkombëtare ishte pikërisht që një pjesë e sovranitetit shtetëror të bartet në këto organizata, shtetet anëtare janë të obliguara t’i përmbushin detyrat dhe detyrimet që dalin nga rezolutat që nxirren në këto organizata.

Stephen Krasner shpjegon se ekzistojnë tri mënyra të cilat përdorin termin e sovranitetit, së pari sovraniteti i të qenurit në familje e cila ka të bëjë me përbërjen dhe efektivitetin e autoritetit publik brenda shtetit. Së dyti, sovraniteti ndërvarësisë, efektivitetin dhe aftësinë e shtetit për të vëzhguar dhe monitoruar se çfarë po vjen dhe si do të dalë nga kufijtë e tij, sovraniteti ligjor ndërkombëtar, është njohja nga shtetet, të gjitha shtetet e reja që ekzistojnë dhe statusi i tyre duhet të jetë Sovran.³⁹

Fundi i Luftës së Ftohtë bëri drejtuesin e pushtetit “hegjemionist të ri botëror”, Shtetet e Bashkuara dhe Presidenti George Bush, bëri që të çojë botën e re unipolare me vizionin e tij të një “Rendit të Ri Botëror”. Megjithatë Lufta e Ftohtë ka mbetur në prag të saj, shtetet e dobëta dhe të dështuara që shtrihen nga Afrika e Veriut, Ballkani, Lindja e Mesme në Azinë Jugore”, përveç që nuk kanë lëvizur nga të qenurit ndër-shtetëror, ato edhe sot vazhdojnë të influencohen nga ish grupimet e mëdha shtetërore.⁴⁰

Fundi i Luftës së Ftohtë i lejoj Këshillit të Sigurimit të OKB-së për të përmbushur veprimtarin e tij, pa besnikëri ideologjike dhe arsyetimin e Luftës së Ftohtë, si luftë strategjike që ndikoj në vendimin e saj.

Theksuar nga fakti se gjatë viteve 1990 Këshilli i Sigurimit autorizoi rreth 40 misione paqeruajtëse, këto misione patën për qëllim ndërmjetësimin ndërmjet shteteve ndërluftuese dhe në kontributin e tyre për paqe dhe shtet ndërtim. Deri në fund të Luftës së Ftohtë shtetet kishin mbajtur një qëndrim realist, duke preferuar të zgjidhin trazira të brendshme pa ndërhyrje të jashtme, por kjo ishte për të ndryshuar vetëdijen në rritje globale të krimeve kundër njerëzimit dhe detyrimin moral të sistemit ndërkombëtar për të vepruar pavarësisht nga sovranitetit shtetëror.

Ky entuziazëm për mbrojtjen e popujve të drejtave të njeriut, një morali të përbashkët global dhe integrimin e tij në skenën politike globale, është theksuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Boutros Boutros-Ghali i cili në vitin 1992 tha se “koha për sovranitet absolut dhe ekskluzive megjithatë ka kaluar”⁴¹. Teoria e tij asnjëherë nuk u shoqërua me realitetin.

Organizatave ndërkombëtare kanë një përgjegjësi për të mbrojtur qytetarët e shteteve të tjera sovraane nga e keqja, kjo u bë e përhapur në epokën pas Luftës së Ftohtë, me një rritje të retorikës së të drejtave të njeriut. Kjo u ndikua nga një zhvillim “Global i Shoqërisë Civile” e frymëzuar nga kozmopolitanizmi dhe nocionin e tij për një komunitet botëror të qytetarëve të barabartë, për ndarjen e një morali të vetëm. Kjo rritje në një shoqëri globale civile sinjalizoi një lëvizje larg nga nocioni i sovranitetit realist, interes shtetëror dhe jo-ndërhyrje, për një pikëpamje njerëzore, normative ku të drejtat në të cilat të drejtat e individit lënë mënjane ato të shtetit. Në këtë pikë, mos lejimi i shprehjes dhe gëzimit të të drejtave elementare të qytetarëve nga ana e shtetit nënkupton shkelje esenciale të të drejtave të njeriut. Autorë të tillë si Thomas Weiss⁴² kanë pohuar se diskursi

Gruda, Zejnullah. E Drejta Ndërkombëtare Publike. Prishtinë, 2003 fq -97

Encyclopedia **Aleanca Veriatlantike NATO** është Organizatë regionale e cila u formua më 4 prill 1949 në Washington D.C. Në fillim kishte 10 anëtar ndërsa sot kjo organizatë numëron 28 shtete anëtare. Qëllimi i themelimit të kësaj organizate ishte mbrojtja e Evropës Përendimore nga rreziku që i kanosej nga BRSS-ja, dhe sot lirish mund të konsiderohet fuqia më e madhe ushtarake në rruzullin tokësor.

Krasner, Stephen.D. Sovereignty Organised Hypocrisy. Princeton UP, 1999 fq - 138

Hehir, Aidan. Humanitarian Intervention after Kosovo: Iraq, Darfur and the Record of Global Civil Society Hardcover, 2008 fq -190

Encyclopedia **Butros Butros Ghali** ishte sekretari i gjashtë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara nga janari i vitit 1992 deri në dhjetor të vitit 1996. Gjatë mandatit të tij si Sekretar i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara ndodhën disa ngjarje, kriza Botërore si : shpërbërja e Jugosllavisë dhe gjenocidi në Ruandë.

www.alibris.com **Thomas Weiss** është profesor i Shkencave Politike në City University of New York, dhe drejtor i Institutit për Studime

normativ ishte aq i suksesshëm në respektimin e të drejtave të njeriut së bashku me katër karakteristikat e sovranitetit të territorit të shtetit, autoritetit dhe respektimi të të drejtave të popullsisë.⁴³

Kombet e Bashkuara u përgjigjën siç duhet duke futur rezoluta që përshkruajnë reagimin ndërkombëtar dhe ndërhyrjen humanitare. Rezoluta A/RES/60/1 tregon se në qoftë se një shtet nuk arrin të mbrojë qytetarët e tij atëherë bashkësia ndërkombëtare, me miratimin e Këshillit të Sigurimit, do të ndërmarrë veprime kolektive, në një kohë caktuar dhe në mënyrë vendimtare.

Ndërhyrja në Kosovë nga NATO (1999) pa një rezolutë të Këshillit të Sigurimit, vënë në pah theksin e efektit që ndërhyrja ishte humanitare në sistemin ndërkombëtar, duke çuar në nocionin e moralit dhe duke zëvendësuar ligjin ndërkombëtar.⁴⁴ Shoqëruar me parimin e një shteti, kjo thekson degradim të ngadaltë ndryshimin e konceptit Vestfalian dhe sovranitetin ndërkombëtar ligjor dhe të drejtën e mosndërhyrjes kur të përballen me një epokë globale në ndryshim politik. Kjo është për ruajtjen e njerëzimit dhe mund të konsiderohet si lëvizje pozitive në të drejtën ndërkombëtare.

Si rezultat i një shkelje të ndërvarësisë familje dhe sovranitetit Vestfalian, reflektohet edhe nga komentet e Kombeve të Bashkuara, nga ish Sekretari i Përgjithshëm Kofi Anan i cili ka thënë: “sovranitetit shtetëror, në kuptimin e tij më themelore, është duke u ripërcaktuar nga forcat e globalizimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar” (Kombet e Bashkuara, 1999). Kjo lëvizje drejt një pozite shumë më pluraliste e njohur se ka pasur shumë aktorë në skenën botërore që mund të ndikojnë në ndryshime të politikës botërore. Këto përfshijnë qeveritë, kompanitë transnacionale (TNCS), të tilla si Microsoft, organizatat ndërqeveritare (ONQ), të tilla si Kombet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian, si dhe ndërkombëtare jo-qeveritare (OJQ ndërkombëtare), të tilla si Amnesty International, Paqa e Gjellbër e tjera. Të gjitha këto kanë ndikuar në mendimin politik dhe vendim-marrës në disa probleme në mes të aktorëve ndërkombëtar.

Kjo rezultoi me Bashkimin Evropian në mënyrë efektive në menaxhimin e ekonomive të këtyre shteteve sovraane, zgjedhja e udhëheqësve nga qytetarët evropian në kundërshtim me parimin e sovranitetit të brendshëm, ndërkombëtar ligjor dhe Vestfalian.⁴⁵

Një tjetër efekt i globalizimit mbi sovranitetin shtetëror ka qenë natyra e ndryshimit të zhvillimit të luftërave, që nga konfliktet ndërmjet shteteve brenda territoreve të përcaktuara, të konflikteve midis shteteve sovraane dhe ideologjive të organizatave terroriste të nxitura nga kultura të tilla siç është Al Kaida.

Më parë shumica e organizatave terroriste janë vendosur në një shtet të vetëm. Tani grupet terroriste kanë anëtarë që rrjedhin nga shoqëritë e gjithë botes dhe veprojnë globalisht. Shkaku i lëvizjeve të tilla terroriste mendohet nga disa studiues, të jenë përhapja e idealeve perëndimore liberale dhe materializmi saj, e cila nga ana tjetër ka lënë disa ndjenja, kultura të tjera të kërcënuara, duke besuar se e vetmja mënyrë për të ruajtur kulturën e tyre është përmes përdorimit të dhunës. Kjo ka çuar në një ndryshim në mënyrë që grupet terroriste luftarake të unifikohen dhe në një «bashkim» të sovranitetit për të mirën e përbashkët, duke shfrytëzuar edhe strukturat të inteligjencës.

Si i tillë koncepti Vestfalian, ndërvarësisë dhe sovraniteti ligjor ndërkombëtar të jetë në gjendje për tu përballuar me këtë kërcënim të ri global organizatat janë të detyruara për të përshtatur një mënyrë pozitive për sigurinë e qytetarëve global.⁴⁶

Në mënyrë që të bëjë këtë, nocioni i sovranitetit shtetëror në fund të Luftës së Ftohtë u shqyrtua, në veçanti ai Vestfalian. Ndërvarësia dhe sovraniteti juridik ndërkombëtar, e ndjekur nga gjeo-politik e efektit të përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe ndikimin e saj në sovranitetin shtetëror. Pastaj shqyrtimi i ndikimit në rritjen e retorikës së të drejtave të njeriut, nëpërmjet një zhvillim të Shoqërisë Civile Globale dhe ndikimi i saj mbi sovranitetin shtetëror. Ndikimi i globalizimit ka sjellë ndryshimin e sovranitetit shtetëror, përkatësisht një sistem ekonomik global dhe kërcënim të ri terrorist. Duke pasur parasysh të gjitha këto, mund të shihet se natyra e sovranitetit ka ndryshuar në mënyrë pozitive, në kuptimin që është e nevojshme në një botë të globalizuar të mbajë llogari për shtetet sovraane që nuk mbrojnë qytetarët e tyre dhe të ndërhyjë kur ka shkelje të të drejtave elementare të garantuara me konventa ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

E gjithë kjo për të garantuar një botë ku vlerat e mirëfillta morale zënë vend në shtetet, kombet dhe shoqërinë globale, e cila sa vjen e formësohet si shoqëri demokratike.

Shteti si subjekt në të drejtën ndërkombëtare ka detyra dhe detyrime kombëtare dhe ndërkombëtare, duke u nisur nga obligimet që ka ndaj qytetarëve të vetë, e deri tek obligimet që ka ndaj bashkësisë dhe organizatave ndërkombëtare.

Paprekshmëria e sovranitetit absolut të shtetit, ka krijuar një siguri (pasiguri tek qytetarët në shtete autoritare) të madhe dhe një vetëbesim duke kryer veprime të ndryshme (të liga) dhe duke mos njofto asnjë autoritet tjetër më të lartë. Ngjarjet shokuese të cilat shokuan tërë njerëzimin vunë në lëvizje bashkësinë ndërkombëtare duke kërkuar një zgjidhje për tu ardhur në ndihmë viktimave të krimit.

Zgjidhja ishte intervenimi humanitar, kjo ishte baza ligjore që u gjend për të shpëtuar jetërat e njerëzve të pafajshëm. Me të drejtë qeveria e Britanisë së Madhe deklaroi se tashmë është krijuar një bazë ligjore e cila do të shërbejë edhe për raste tjera në të ardhmen. Pra me paraqitjen e intervenimit humanitar, sovraniteti i shtetit nuk mund të jetë absolut apo i paprekshëm. Intervenimi Humanitar përkufizohet si intervenim i shteteve në një shtet tjetër për ndërrimin e gjendjes ekzistuese.

Ndërkombëtare. Ai ishte redaktor dhe autor i më se 35 titujsh të ndryshëm rreth çësjeve Multilaterale Shkencore për Paqen dhe Sigurinë Ndërkombëtare, Intervenimin Humanitar dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm.

⁴³ Hehir, Aidan. The Myth of the Failed State and the War on Terror: A Challenge to the Conventional Wisdom (2003) fq - 43
Kombet e Bashkuara Asambleja e Përgjithshme, 2005: A/RES/60/1

⁴⁵ Paris, Roland, and Timothy D. Sisk. The Dilemmas of Statebuilding: Confronting the Contradictions of Postwar Peace Operations. London: Routledge, 2009, fq 126

⁴⁶ Hehir, Aidan. The Myth of the Failed State and the War on Terror: A Challenge to the Conventional Wisdom 2003 fq - 186

Të drejtat e njeriut tashmë kanë marr një karakter ndërkombëtar dhe nuk mund të trajtohen si çështje të brendshme të shteteve, përgjegjësi e bashkësisë dhe organizatave ndërkombëtare, prandaj sovraniteti i shtetit nuk përbën precedent për sulme nga jashtë për ndërrimin e gjendjes ekzistuese.

Humbja e Sovranitetit dhe krijimi i shteteve të reja

Shfaqja e lufrave dhe e problemeve të ndryshme që sot po ndodhin në botë, po shpie deri tek zbehja e sovranitetit shtetëror dhe deri tek krijimi i shteteve të reja që po dalin si pasojë e lufrave apo e vullnetit të një pjese të qytetarëve.

Krijimi i shteteve të reja vie si rezultat i shprehjes së drejtës së Vetëvendosjes dhe si pasojë e mos përbushjeve të detyrimeve ndërkombëtare nga shtete me theks të veçantë ruajtja dhe kultivimi i të drejtave të njeriut⁴⁷.

Sovraniteti është monopol i shtetit që përmes forcës fizike realizon qëllimet e pushtetit shtetëror, me vet faktin se ky monopol i forcës fizike shuhet ose dobësohet deri në atë shkallë sa që nuk është në gjendje që të kontrollojë situatatën faktike apo pushtetin brenda hapësirës përkatese, humbë legjitimitetin e vet shtetëror.

Mënyra tjetër e pushimit të sovranitetit shtetëror në teorinë e shtetit dhe së drejtës, e cila konsiderohet si mundësi origjinale e të cilën e gjejm edhe në teorinë e së kaluarës historike madje që nga Roma e vjetër është Okupimi.⁴⁸

Okupimi⁴⁹ nënkupton jo vetëm përmbysjen dhe shuarjen e Sovranitetit shtetëror, por edhe nënshkrimin e popullit vendas duke krijuar strukturat shtetërore në tërë hapësirën e okupuar⁵⁰.

Bota moderne nuk e njeh pushtetin apo autoritetin e një shteti në një vend në qoftëse ai territor është okupuar dhe se kjo gjendje konsiderohet si gjendje e përkohëshme sepse këtyre institucioneve nuk i binden popullata e okupuar, dhe kjo gjendje e këtillë nuk mund të gjejë perkrashje ndërkombëtare në aspektin formalo-juridik.

Krijimi i federatave dhe i konfederatave bëri zëvendësimin e sovranitetit shtetëror nga federata apo të themi se federata është bartëse e sovranitetit shtetëror, ndërsa anëtarët gëzojnë njëfarë lloji autonomie brenda për brenda territorit të vetë por vendimet e merren në kuadër të federatës.

Bashkimi Evropian është një lloj sui generis i federatës ku me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës⁵¹ institucionet e Bashkimit Evropian bartin të gjitha përgjegjësitë në të gjitha fushat sa i përket vendimëarrjes ndërsa institucionet kombëtare bëjnë implementimin si dhe japin ndihmën e tyre këshilluese ndaj institucioneve të BE-së.

Federatat si ajo e Jugosllavis dhe e Bashkimit Sovjetik ishin federata që centralizuan të gjithë pushtetin në qendër dhe kishin një sistem komunist dhe bëri që për një kohë jo shumë të gjatë të shuheshin dhe të pamvarësohen shumë shtete si pasojë e shpërbërjes së këtyre federatave.

Rasti i fundit ishte Kosova, e cila ishte njësi federative që kishte statutin e autonomisë në federatë, por pasi që popullit shqipëtar të Kosovës iu bënë shumë padrejtësi iu shkelën të drejtat më elementare si dhe iu ndalu çdo formë e shkollimit dhe e avansimit të shoqërisë, rezultoi që të krijohet një ushtri guerile e që me kalimin e kohës u njohë nga bashkësia ndërkombëtare si një ushtri **çlirimtare, që shënoi fillimin e një fundi të një padrejtësie dhe një gjenocidi që u bë ndaj një populli të pambrojtur.**

Serbia me 10 Qershor 1999 u tërhoq nga Kosova me forcat e saj, sipas Rezolutës 1244 në Kosovë u vendosën trupat e KFOR-it nën mandatin e Këshillit Sigurimit të OKB-së dhe kjo ishte një fazë kalimtare deri në përcaktimin e statusit politik të Kosovës.

Bibliografia

Burimet Primare

Hasani, Enver. Vetëvendosja, Integriteti Territorial Dhe Stabiliteti Ndërkombëtar: Rasti I Jugosllavisë. Prishtinë: Buzuku, 2003

Hehir, Aidan. The Myth of the Failed State and the War on Terror: A Challenge to the Conventional Wisdom (2003)

Filo Llambrò: Historia për sistemet e qeverisjes, Extra, Tiranë, 2003

Puto, Arben. E Drejta Ndërkombëtare Publike. Tiranë: Botimet Dudaj, 2010.

Richmond, Oliver P., and Jason Franks. Liberal Peace Transitions: Between Statebuilding and Peacebuilding. Edinburgh:

Edinburgh UP, 2009

Prof.Dr. Enver Hasani në librin e tij Vetëvendosja, Integriteti territorial dhe stabiliteti ndërkombëtar: Rasti I Jugosllavisë. **E drejta e Vetëvendosjes** është e drejtë e cila parashikohet edhe në Kartën e OKB-së. Ajo përcakton mardhëniet midis Kombeve që bazohet mbi respektimin dhe parimin e barazisë dhe të drejtën e Vetëvendosjes. Në nenin 1 paragrafi 2 të Kartës së OKB-së parashihet që të gjithë popujt kanë të drejtë të vetëvendosin, ata mund të vendosin për statusin e vetë politit, zhvillimin ekonomik, kulturor dhe social. Një gjë të tillë e parashihet edhe Akti Final I vitit 1975 që u vendos në Konferencën për Siguri dhe Bahkëpunim në Evropë gjithashtu egziston edhe Deklarata e Mos-ndërrhyrjes dhe Interferencave në punët e brendëshme të shteteve.

Ismaili, Osman.-Fillet e së Drejtës: Prishtinë, fq. 29.

Ismaili, Osman.-Fillet e së Drejtës: Prishtinë fq – 29 **Okupimi** nënkupton jo vetëm përmbysjen dhe shuarjen e Sovranitetit shtetëror, por edhe nënshkrimin e popullit vendas duke krijuar strukturat e shtetërore në tërë hapësirën e okupuar.

Ismaili, Osman.-Fillet e së Drejtës: Prishtinë fq - 29

⁵¹ Reka, Blerim; Sylja, Ylber. “Hyryje në të Drejtën e Unionit Evropian”. Tetovë. 2007, fq. 13 **Traktati i Libonës** është traktati i fundit i Bashkimit Evropian i cili në BE sjell shumë ndryshime të mëdha ndërsa disa prej tyre janë: perfunimi i funksionimit të sistemit tri shtyllësh, përfaqësuesin për Politikë të Jashtëme të BE-së, mundësinë e zgjedhimit të BE-së, Presidentin e BE-së, mënyrën e marrjes së vendimeve brenda institucioneve të BE-së etj. Vlen të theksohet se ky Traktat pati shumë kundërshtime nga qytetarët dhe shtetet e BE-së dhe përfundimisht me 1 dhjetor 2009 hyri në fuqi dhe presidenti Çek pati deklaruar se Sovraniteti i shtetit Çek mori fund përfundimisht.

- Paris, Roland, and Timothy D. Sisk. *The Dilemmas of Statebuilding: Confronting the Contradictions of Postwar Peace Operations*. London: Routledge, 2009
- Gruda, Zejnullah, *E drejta Ndërkombëtare Publike*, Prishtinë, 2003
- Gruda, Zejnullah, *Manual Diplomatik*, Prishtinë, 2009
- Hans Peter Gasser, *E drejta Ndërkombëtare Humanitare*, Dhjetor 2000
- M. Adler: *Ordering International Politics: Identity, Crisis and Representational Force*.
- Weller, Marc: *Shtetësia e Kontestuar: Administrimi Ndërkombëtar i Luftës së Kosovës Për Pavarësi*. Prishtinë: Përktheu nga origjinali anglisht Flaka Suroi, Koha, 2009
- Gruda, Zejnullah: *E drejta Ndërkombëtare Publike*, Prishtinë, 2009
- Krasner, Stephen. D. *Sovereignty Organised Hypocrisy*. : Princeton UP, 1999
- Hehir, Aidan. *Humanitarian Intervention after Kosovo: Iraq, Darfur and the Record of Global Civil Society Hardcover*, 2008
- Kuqi, Hajredin and Bilalli, Asllan: *E Drejta Ndërkombëtare Private*: Prishtinë, 2009
- Hans Peter Gasser, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, “E drejta ndërkombëtare humanitare”, Ed. Pedone, dhjetor 2000
- Ismaili, Osman. -*Fillimet e së Drejtës*: Prishtinë
- Reka, Blerim; Sylva, Ylber. “Hyrje në të Drejtën e Unionit Europian”. Tetovë. 200

Burimet nga Interneti

www.Encyclopedia.com
www.britannica.com
www.stahlshmidt-inc.com
www.alibris.com

USHTRIMI I SOVRANITETIT SHTETËROR DHE PREZENCA E ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE ME KOMPETENCA EKZEKUTIVE NE REPUBLIKËN E KOSOVËS

SAMEDIN MEHMETI

Universiteti Evropian i Tiranës, Fakulteti Juridik, Shkolla Doktorale

ABSTRAKT

Për të kuptuar më mire ushtrimin e sovranitetit shtetëror në Republikën e Kosovës si koncept teorik, politik dhe juridik, më e arsyeshme është të fillohet me pyetjen klasike: Çka kuptojmë me konceptin klasik të ushtrimit të sovranitetit shtetëror? Por nëse këtë pyetje e shtrojmë në kontekst të ushtrimit të sovranitetit shtetëror në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, prezencës së organizatave të ndryshme ndërkombëtare që ushtrojnë edhe kompetenca ekzekutive si dhe decentralizimit si proces i rëndësishëm në ofrimin e mundësive dhe forcimin e mekanizmave për qytetarin, atëherë edhe përgjigjet që i marrim në këtë pyetje do të mund të jenë të ndryshme.

Në rrethanat dhe zhvillimet aktuale politike dhe juridike nëpër të cilat po kalon Republika e Kosovës çështja e ushtrimit të sovranitetit në të tërë territorin e sidomos ushtrimit të sovranitetit shtetëror në kuptimin klasik të fjalës lenë vërtet ende shumë për të dëshiruar. Kosova si një vend i vogël për nga territori dhe numri i banoreve, me një infrastrukturë që ende është në fazën shumë fillestare të zhvillimit, zhvillim jo shumë të kënaqshëm ekonomik, me probleme të shumta politike me theks të veçantë në pjesën veriore të vendit të banuar me shumicë të minoritetit serb, minoritet ky i cili ka probleme në bindjen ndaj pushtetit qendror. Në periudhën afat shkurtër do të tingëllonte gati si një luks i papërbalueshëm të flitet për ushtrim të sovranitetit klasik në të gjithë territorin e Kosovës në këtë fazë të zhvillimit. Ndoshta, procesi i decentralizimit përmes të cilit qytetarëve ju jepet mundësia e marrjes së shërbimeve por edhe në formë të drejtpërdrejtë pjesëmarrjes në ushtrimin e kompetencave në nivelin lokal posaçërisht në vendet e banuara me pjesëtarë të minoriteteve, do të ishte një zgjidhje që mund të ofronte qëndrueshmëri.

Fjalë kyç: *Sovranitet, Decentralizim, Organizata ndërkombëtare, Pushtet ekzekutiv, Minoritete.*

1. Hyrje

Të kuptuarit e nocionit sovranitet në kuptimin klasik të kësaj fjale, tanimë në shoqërinë bashkëkohore është vështirë të trajtohet. Kjo si pasojë e ndryshimeve të mëdha sociale, ekonomike, politike dhe juridike që po ndodhin në përgjithësi nëpër botë, e veçanërisht në Evropën Perëndimore. Madje nganjëherë shkohet aq sa larg sa të konkludohet se sovraniteti si koncept teorik, politik por edhe juridik, në shoqërinë bashkëkohore e ka kuptimin krejt ndryshe nga nocioni fillestar tradicional i të kuptuarit te nocionit sovranitet. Andaj më e arsyeshme është të fillohet me pyetjen racionale: Çka kuptojmë me sovranitet shtetëror?

Varësisht nga vendi dhe koha kur kjo pyetje shtrihet edhe përgjigjet në këtë pyetje do të jenë të ndryshme.

Por sigurisht se përgjigjet do të jenë tejet interesante dhe shumë larg nocionit klasik nëse këtë pyetje e shtrojmë në kontekst të sovranitetit shtetëror të Republikës së Kosovës. Gjithsesi edhe përgjigjet që i marrim, do të mund të jenë të ndryshme nga përgjigjet që do ti merrim në kontekst të shtruarjes së kësaj pyetje në lidhje me ushtrimin e sovranitetit në shtetet tjera. Sidomos kur bëhet fjalë për aspektin praktik të ushtrimit të sovranitetit, në Republikën e Kosovës dhe atë në hapësira të caktuara brenda territorit dhe në periudha të ndryshme kohore.

Në aspektin teorik sipas konceptit klasik, për ekzistimin sovranitetit parapakisht duhet të ekzistoj e drejta që një bashkësi e caktuar të posedoj mundësin të vendos vet për çështje të caktuara të cilat kanë rëndësi politike apo nacionale, apo koncepti i vetëvendosjes. Edhe pse këto dy koncepte shpesh duken të ngjashme, në fakt në mes tyre ekziston një dallim i madh, sidomos në aspektin e të drejtës ndërkombëtare. Prandaj me të drejtë mund të konstatohet se për nga aspekti i të drejtës ndërkombëtare edhe përkundër faktit se sovraniteti dhe vetëvendosja janë gjithsesi dy koncepte bazë shpesh ndodh që të bien në kundërshtim me njëra tjetrën. Për shembull në rastin e Kosovës kemi një situatë tipike që i përgjigjet kësaj dileme dhe kundërshtimi. (Lipušček, 2008).

Në rrethanat dhe zhvillimet momentale nëpër të cilat po kalon shteti i Kosovës çështja e sovranitetit sidomos në kuptimin klasik të fjalës lenë vërtet ende shume për të dëshiruar. Nëse analizohet gjendja e tanishme, ku Kosova si një vend i vogël për nga territori dhe numri i banorëve, me një infrastrukturë që ende është në fazën shumë fillestare të zhvillimit, me resurse humane të kënaqshme, por jo patjetër edhe të kualifikuara sipas standardeve dhe të afta për ta përballuar konkurrencën dhe pak frymëzuara për të ardhmen, zhvillim jo të kënaqshëm ekonomik, probleme politike, sociale e të natyrave të tjera. Do të tingëllonte gati si një luks i papërballueshëm të flitet për sovranitet klasik në këtë fazë të zhvillimit.

Çfarë në të vërtetë kuptojmë me konceptin e sovranitetit shtetëror? Kur përmendim fjalën sovranitet, si term në kuptim të përgjithshëm, kemi në mendje një forcë apo fuqi supreme, në kuptim të gjerë. Që do të thotë fjala është për diçka absolute dhe gjithsesi të pakontrollueshme nga të tjerët. Nga kjo që u tha më lartë, ushtrimi sovranitetit do të thotë gjendje në të cilën subjekt ushtrues i sovranitetit është më i larti, më superior, dhe të gjithë në raport më të janë më të ulët dhe të varur. Ndërsa kur dëshirojmë të flasim për sovranitetin shtetëror, themi se një shtet i pavarur është sovran në territorin që kontrollon, vetëm atëherë kur është i qeverisur dhe të gjitha kompetencat specifike politike janë nxjerrë nga kjo qeveri. Pavarësia e një shteti, është e kombinuar me të drejtën dhe fuqinë e rregullimit të punëve të brendshme dhe pa ndërhyrje të huaj. Pra sovraniteti është fuqia e nevojshme e një shteti për të qeverisur veten, duke filluar me: ekzekutimin dhe zbatimin e ligjeve, imponuar mbledhjen e tatimeve, duke e bërë luftën dhe paqen, nënshkrimin e traktateve ndërkombëtare, angazhimin për marrëdhëniet politike, ekonomike dhe tregti me vendet të tjera. (<http://legal-dictionary.thefreedictionary.com/State+sovereignty>, 14 /09/2012, 14:00).

Edhe përkundër faktit se koncepti i sovranitetit që ne e njohim sot nuk ekzistonte para shekullit të 16-të, kjo nuk do të thotë se ky fenomeni i tillë nuk ekzistonte në realitetin politik dhe shtetëror të shteteve të asaj kohe, dhe se sovraniteti shtetëror i tillë nuk mund të ishte konceptuar ndryshe (Benoist, 1999).

Sovranitetin shtetëror si koncept politiko-juridik, së pari duhet ta shikojmë në zhvillimin e tij gjatë periudhave të ndryshme kohore. Padyshim se ky koncept praktik dhe politik mbi sovranitetin shtetëror, është ndërtuar dhe zhvilluar që nga koha e paraqitjes së shteteve të para si etnitet, sepse në fund fare këto janë dy koncepte (shteti dhe sovraniteti) që kanë problem nëse janë pa njëra tjetrën. Zanafillat e teorive për sovranitetin i gjejmë në Egjiptin e vjetër, madje edhe në Greqinë antike mendimtari dhe filozofi shumë i rëndësishëm i kohës Platoni, filozofët i përcaktonte si bartës të pushtetit shtetëror sovran, por më vonë këtë funksion e lidh me ligjet. (Dalton, 1998). Ndërsa në Romën e vjetër pushteti i shtetëror ishte pushteti më i lartë në perandori dhe përveç kësaj ishte njëkohësisht edhe i pavarur në raport me të gjitha pushtetet e tjera.

2. Sovraniteti dhe pushteti shtetëror në Kosovë

Një faktor shumë i rëndësishëm në ushtrimin e sovranitetit shtetëror në një territor dhe popullatë të caktuar, është pushteti shtetëror. Faktikisht pa ushtrim të pushtetit shtetëror në praktikë, pothuajse as që mund të bëhet fjale për sovranitet shtetëror të mirëfilltë faktik. Me fjale të tjera sovraniteti shtetëror lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e pushtetit shtetëror brenda territorit të vendit. E një rëndësi të veçantë në këtë aspekt është edhe lidhshmëria e dukurive dhe ndodhive të ndryshme politike dhe juridike, qoftë në aspektin e brendshëm apo edhe në marrëdhëniet dhe zhvillimet e jashtme. Shikuar nga ky këndvështrim pushteti shtetëror do të duhej të ishte pushtet madhor dhe i pakufishëm në territor të caktuar.

Në të shumtën e rasteve me pushtetin shtetëror identifikohet shteti në tërësi, ose fuqia e pushtetit shtetëror personifikohet me fuqinë e shtetit si etnitet. Por në fakt pushteti shtetëror shprehet në autorizimet e organeve shtetërore që të nxjerrin

dhe zbatojnë akte të caktuara normativo-juridike. Kjo, natyrisht se nënkupton që aktet normative i miratohen nga organet shtetërore të pushtetit, të cilat sipas rregullit do të duhej të burojnë nga kushtetuta si akti më i lartë normativ-juridik dhe politik i shtetit të caktuar. Përveç që përkujdesen për nxjerrjen e akteve normative, organet e pushtetit shtetëror duhet që të sigurojnë zbatimin e tyre, madje në raste të parapara me ligj edhe përmes shtrëngimit, apo përdorimit të mjeteve të detyrimit. Edhe pse Kushtetuta e Kosovës e përkufizon Republikën e Kosovës si “një shtet të pavarur, sovran, unik dhe të pandashëm” (Kushtetuta e Kosovës, 2008). Në praktik, ka edhe raste kur pushteti shtetëror nuk arrin që të shtrijë pushtetin e vet ekzekutiv në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, në të gjithë territorin e vet. Siç është rasti me komunat veriore të Kosovës, ku organet e pushtetit qendror nuk kanë as prezencë, ose kanë prezencë fare të limituar. Në këtë rast jo vetëm që nuk ka prezencë të mjaftueshme të organeve të pushtetit qendror, por pushteti qendror i Republikës së Kosovës nuk arrin as të implementoj normat juridike legjitime në këtë pjesë të territorit të vet. Kjo që u shtrua këtu si problem, sigurisht se ngrit edhe dilemat rreth çështjes së ushtrimit të sovranitetit shtetëror në këtë pjesë të territorit.

Edhe përkundër faktit se në Republikën e Kosovës sovraniteti i takon popullit, përkatësisht ushtrohet përmes organeve të zgjedhura nga populli, ka raste kur përgjegjësi të caktuara bartën të organizatat ndërkombëtare. Ky është rasti kur për çështje të caktuara në bazë të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, disa kompetenca të pushtetit mund të kalojnë në kompetencë të organizatave ndërkombëtare (Kushtetuta e Kosovës, 2008).

3. Organet shtetërore të pushtetit në Republikën e Kosovës

Pushtetin faktik në Republikën Kosovës e ushtrojnë në forma të ndryshme një konglomerat i tërë i organeve që kanë autoritete të ndryshme, varësisht nga pozita e tyre në strukturën e pushtetit. Por ajo që bën edhe më interesant sovranitetin dhe ushtrimin e pushtetit në Kosovë, është fakti se jo vetëm për nga aspekti normativ por edhe praktikisht një pjesë e pushtetit ushtrohet nga organizata të ndryshme ndërkombëtare. Kjo për shkak të rrethanave historike nëpër të cilat ka kaluar krijimi i shtetit i ri të Kosovës. Shtet ky i cili ende po përballet me shumë probleme rreth njohjes ndërkombëtare. Deri më tani, janë 109 shtete kanë njohur ndërkombëtarisht Republikën e Kosovës, si shtet të pavarur dhe sovran (<http://kosova.org/post/Lista-e-shteteve-qe-kanë-pranuar-pavarësinë-e-Kosovës-14/09/2014,15:00>).

Se sovranitetit shtetëror të Republikës së Kosovës i kushtohet një rëndësi e posaçme, tregon edhe fakti se në nenin 2 të aktit më të lartë juridik, përkatësisht Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ceket takstativisht, se sovraniteti buron nga populli, i takon popullit dhe do të ushtrohet në pajtim me kushtetutën. Në po këtë nen, përkatësisht në paragrafin 2 përcaktohet edhe çështja e integritetit territorial, ku territori i Republikës së Kosovës përcaktohet si i pandashëm dhe i patjetërsueshëm. Që jep një mesazh të qartë se sovraniteti shtetëror do të ushtrohet në të gjitha pjesët e territorit të Republikës së Kosovës. Ky nen thotë se sovraniteti jo vetëm që do të ushtrohet në të gjitha pjesët e territorit të Republikës së Kosovës, por njëkohësisht edhe me të gjitha mjetet e përcaktuara me Kushtetutë do të mbrohet ky sovranitet. Për çka Republika e Kosovës do të mund edhe të marrë pjesë në sistemet të sigurisë ndërkombëtare (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008).

Republika e Kosovës përcaktohet si vend demokratik, ku sovraniteti shtetëror ushtrohet në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Duke bërë një ndarje të balancuar të pushteteve: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Ku të tri pushtet kanë autoritet, pavarësi të caktuar dhe kontroll. Edhe pse çdonjëri nga të tre pushtetet ka një rol të veçantë, që plotëson edhe funksionet e pushteteve të tjera, ato parimisht janë të ndara dhe pavarura nga njëra tjetra. Në realitet, në jetën praktike, funksionaliteti i tyre është i pamundur pa ndërlidhjen në mes vete. Sidoqoftë, të tre pushtetet janë të ndërlidhura dhe në një farë shkalle rolet e tyre përputhen me njëra tjetrën.

3.1 Pushteti legjislativ në Republikën e Kosovës

Pushteti legjislativ ka rëndësi shumë të madhe për shtetin sepse ai paraqet vullnetin e popullit. Sepse duke qenë një fuqi e deleguar nga populli, bartësit e pushtetit legjislativ, nuk mund ta delegojnë këtë autoritet të tërë, sepse populli këtë pushtet dhe detyrë u a ka deleguar atyre në zgjedhje. Autorizimet për të bërë ligje bien ekskluzivisht mbi të zgjedhurit e popullit pra mbi parlamentin, sepse fuqia e legjislativit rrjedh nga vullneti i popullit (<http://www.ncsl.org/legislatures-elections/legislatures/delegation-of-legislative-power.aspx> 18.09.2012 12:15).

Parimisht edhe në Republikën e Kosovës sikurse edhe në vende të tjera pushteti legjislativ është përgjegjës për miratimin e ligjeve që janë pasqyruese të vullnetit popullor. Duke pasur parasysh faktin se në jetë, është shumë e vështirë të përcaktohet vullneti autentik i popullit, madje edhe është vështirë të bëhet një lloj marrëveshje në mes të njerëzve të vendit rreth miratimit të një norme të caktuar. Andaj Kuvendi i Republikës së Kosovës si institucioni ligjvënës zgjidhet nga populli dhe paraqet në një formë sovranitetin e popullit të Kosovës, të paktën për nga aspekti formalo-juridik.

Kuvendi i Kosovës është njëdhomësh dhe përbëhet nga 120 deputetët të cilët zgjidhen në zgjedhje të përgjithshme parlamentare. Por ajo që bën interesante dhe të veçantë këtë përbërje të Kuvendit të Kosovës, është fakti se nga 120 deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës vendet përkatësisht ulëset e 20 deputeteve, paraprakisht janë të rezervuara për komunitetet që nuk përbejnë popullatën shumice të Kosovës, pavarësisht nga rezultatet që dalin nga zgjedhjet e lira parlamentare. Grupet etnike të cilat nuk përbejnë popullatën shumice në Kosovë përveç këtyre 20 vendeve të garantuara gjithashtu varësisht nga numri i votave që ata fitojnë në zgjedhje parlamentare do të mund të mund do të sigurojnë edhe të tjera ulëse përkatësit mandate deputetesh në Kuvendin e Kosovës jashtë atyre të rezervuara për ata.

Ky fenomen interesant që rrallë haset në praktikën parlamentare të vendeve të tjera, është si pasojë e zhvillimeve historike nëpër të cilat ka kaluar populli i Kosovës. Në zgjedhjet e para të pasluftës në Kosovë të mbajtura në vitin 2000, minoriteti Serb refuzonte të merrte pjesë në jetën publike dhe politike të vendit andaj komuniteti ndërkombëtar i instaluar në Kosovë, i cili në atë kohë kishte edhe fuqi jashtëzakonisht të mëdha ekzekutive, me qëllim të nxitjes së komunitetit Serb që të marrë pjesë në zgjedhje, dhe me këtë edhe në jetën politike të vendit ofroj vendet e rezervuara në Kuvendin e Kosovës si mundësi për komunitete pakice. Kjo gjendje ka ndryshuar për disa nuanca me aprovimin e Kushtetutës së re e cila ka ndryshuar këtë, dhe tani partitë minoritare do të zënë ulëset e rezervuara vetëm nëse fitojnë më pak vota se sa ato që nevojiten për të fituar ato ulëse. Në këtë mënyrë grupet etnike minoritare, nuk do të jenë në gjendje që të mbajnë ulëset e rezervuara dhe të fitojnë ulëse shtesë në Kuvendin e Republikës së Kosovës (Pushteti në Kosovën e pas pavarësisë, 2009).

Është në kompetencën e Kuvendit të Kosovës të miratoj ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme. Por aji ka edhe kompetencë të vendos lidhur me ndryshimet e mundshme të Kushtetutës së Kosovës, si edhe të shpall referendum për çështje të ndryshme të rëndësisë shoqërore. Kuvendi i Kosovës miraton buxhetin, ratifikon aktet ndërkombëtare dhe një mori kompetencash lidhur me çështje të ndryshme (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008). Kuvendi i Kosovës emëron dhe kontrollon apo në një formë mbikëqyr pozitën ekzekutive të agjencive ekzistuese të financuara nga ky institucion.

Parimisht mbledhjet apo seancat e Kuvendit të Kosovës janë publike dhe do të duhet të përshkruheshin me një transparencë, mirëpo praktika tregon se në komisionet parlamentare ka shume raste kur gjatë mbledhjeve të komisioneve, zakonisht rezervohen 5 ose 6 ulëse për publikun dhe mediat, të cilat në të shumtën e rasteve nuk janë të mjaftueshme. Kjo edhe përkundër faktit se rregullorja e punës së kuvendit nuk e adreson në mënyrë të qartë çështjen e transparencës së punimeve të komisioneve dhe në mungesë të transkriptove për publikun, mbledhjet e Kryesisë së Kuvendit vazhdojnë të jenë të mbyllura për organizatat lokale të shoqërisë civile, ndërsa janë të hapura vetëm për institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, siç janë Misioni i OSBE-së, Zyra Ndërkombëtare Civile (ICO), (<http://www.kdi-kosova.org/publications/cimap/kpp.pdf> 12/09/2012, 11:00). Është kjo një çështje e cila nganjëherë krijon edhe hutim të publiku, sepse parimisht kuvendi do të duhej të ishte institucioni i transparencës.

Kuvendi i Kosovës ka edhe funksionin zgjedhës, përkatësisht lidhet me zgjedhjen e disa funksionarëve të lartë të shtetit si për shembull Presidentin e vendit. Ndërsa një nga organet kryesor që formohet në parlament por që në fakt i takon një pushteti tjetër, pra pushtetit ekzekutiv është qeveria, e cila propozohet nga mandatarin për formimin e qeverisë dhe që zgjidhet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Edhe pse Qeveria parimisht nuk varet nga Kuvendi por përgjigjet para tij.

Nëse e analizojmë për nga aspekti kuantitativ i vëllimit të punës së Kuvendit të Kosovës, do të vërejmë se statistikat tregojnë se kuvendi i Kosovës ka një vëllim të theksuar të aktiviteteve. Për shembull nëse shikojmë raportin lidhur me aktivitetin prej muajit Shkurtit deri në Dhjetor të vitit 2011, do të vërejmë se Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka mbajtur 44 mbledhje plenare, prej tyre 2 të jashtëzakonshme dhe 3 solemne. Që shikuar në kuantum tregon një numër solid të mbledhjeve. Si që vërehet edhe në tabelën e poshtëshënuar një aktiviteti i ngjeshur vërehet edhe te komisionet parlamentare, të cilat për periudhën e lartë cekur kanë mbajtur 460 mbledhje dhe rreth 279 takime të grupeve punuese për çështje të ndryshme. Komisionet parlamentare kanë bërë shqyrtimin e 80 raporteve vjetore të agjencive të pavarura, 31 vizita pune jashtë vendit, 96 vizita pune në brenda vendit si dhe 68 dëgjime publike. Natyrisht se çdo aktivitet ka rëndësinë e vet por ajo që duhet patjetër të përmendet është aktiviteti ligjvënës ku janë proceduar 94 projektligje, ndërsa janë miratuar 65 ligje (Aktiviteti legjislativ i Kuvendit të Kosovës, 2011).

Rezultatet kuantitative jo gjithnjë janë në korrespondencë të drejtë me ato kualitative, andaj kualiteti i punës së Kuvendit të Kosovës është një çështje që meriton studim me të detajuar, por një gjë është gjithsesi e qartë, dhe atë që nga një demokraci e re si kjo e Kosovës nuk mund të pritet një kualitet shumë i madh i ligjeve dhe akteve tjera normative. Por si duket në Kosovë nuk qëndron problemi në miratim dhe sjelljen e ligjeve, qoftë edhe të atyre të një cilësie dhe kualiteti të lartë. Në Kosovë më shumë problemi qëndron në zbatimin dhe respektimin e ligjit. Kjo mund të jetë e lidhur edhe me trendet aktuale të zhvillimeve në rajon, kulturën e sjelljes konform rregullave dhe çështje që meritojnë një studim të veçantë.

3.2 Pushteti ekzekutiv

Themelimin e pushtetit ekzekutiv në Kosovë, për nga aspekti juridiko-formal e gjejmë në Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, të aprovuar nga Përfaqësuesi i Përkohshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë në vitin 2001. Sipas dokumentit të lartcekur, Qeveria është organ që ushtron pushtetin ekzekutiv dhe zbaton ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës, brenda fushës së përgjegjësisë të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes të parashtruara në këtë Kornizë Kushtetuese. Qeveria përbëhet nga Kryeministri dhe nga Ministrat, ndërsa themelimi i Ministrive dhe organeve ekzekutive behet sipas nevojës për kryerjen e funksioneve brenda kompetencave të Qeverisë. Pas miratimit të Kornizës Kushtetuese, me të cilën ishin vënë bazat e funksionit të institucioneve vetëqeverisëse dhe bartja e kompetencave nga UNMIK tek institucionet e reja, në Shtator të vitit 2001, u nxor edhe Rregullorja 2001/19 për degën ekzekutive të institucioneve vetëqeverisëse (Analize Politikash, 2011). Por ajo që është interesante dhe e veçantë e këtij dokumenti është fakti se sipas këtij dokumenti së paku një Ministër në Qeverinë e Kosovës duhet të jetë nga komuniteti Serb që jeton në Kosovë. Dhe së paku një Ministër tjetër duhet të jetë nga një komunitet jo Serb, pra nga pakicat tjera që jetojnë në Kosovë. (Korniza Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, 2001).

Përafërsisht zgjedhje të njëjta për këtë qeshje ofron edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës e vitit 2008, sipas të cilës qeveria e Kosovës duhet të ketë së paku një Ministër nga komuniteti Serb dhe një Ministër nga ndonjë komunitet tjetër

pakice. Ndërsa në rastin kur qeveria ka në përbërje të vet më shumë se 12 Ministri atëherë duhet të ketë edhe një Ministër të tretë i cili do të përfaqësojë komunitetet jo shumice në Kosovë. (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008).

Pushteti ekzekutiv në Republikën e Kosovës, përbehet nga një tërësi organesh administrative të cilat merren me punët ekzekutive të pushtetit. Qeveria e Republikës së Kosovës është organi kolektiv më i lartë i pushtetit ekzekutiv që bën drejtimin politik dhe ekonomik të vendit, si dhe udhëheq me administratën publike. Qeveria zbaton ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, merr vendime në pajtim me kushtetutën dhe me ligjet në fuqi. Propozon projektligje dhe bën amendamentimin e ligjeve ekzistuese e akteve të tjera, si dhe mund të japë mendimin rreth projektligjeve të cilat nuk janë të propozuara nga ajo. Numri i ministrave dhe organizimi i brendshëm i qeverisë është pothuajse plotësisht në diskrecionin e partisë ose koalicionit që merr pushtetin pas zgjedhjeve. Qeveria aktuale e Republike së Kosovës përbehet nga kryeministri, zëvendës kryeministri dhe ministrat. Por ajo ka edhe një aparat të tere administrativ që përfshin të gjitha zyrat publike që zhvillojnë aktivitet administrativ, konsultativ dhe të kontrollit në emër dhe kompetencë të qeverisë. Anëtarët e Qeverisë së Kosovës gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si anëtarë të Qeverisë (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008).

3.2.1 Kryeministri i Republikës

Kryeministri është eprori më i lartë në pushtetin ekzekutiv kryeson dhe përfaqëson qeverinë. Aji zgjidhet nga partia ose koalicioni që ka marrë numrin më të madh të mandateve në Kuvendin e Kosovës. Mandatari për formimin e qeverisë i propozohet Kuvendit nga Presidenti i Republikës, i cili duhet ti paraqes Kuvendit për miratim përbërjen e qeverisë. Qeveria do të konsiderohet si e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Por nëse kjo nuk ndodh, atëherë Presidenti i Republikës propozon kandidatin tjetër. Kjo çështje edhe paraqiti problem kur në vitin 2014 Kosova, për më shumë se 5 muaj nuk arriti të formohej qeveria e re pas zgjedhjeve. Ishte vendimi i Gjykatës Kushtetuese i cili i dha të drejtë koalicionit parazgjedhor të zgjedhjeve të qe formohej qeverinë, por ky koalicion nuk përbënte shumicën në parlament (http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_ko_119_14_shq.pdf, 25 Nëntor 2014, 16:10). Ndërsa në anën tjetër ishte krijuar koalicion tjetër që ishte formuar pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve dhe që kishte shumicën e votave në parlament, por që asnjëra nga partitë e këtij koalicioni nuk pranonte që ti bashkëngjitej koalicionit parazgjedhor. Situata u zgjidh pas më shumë se 5 muajve me ndihmën e Presidentes së vendit dhe bashkësisë ndërkombëtare prezentë në Kosovë. Posti i kryeministrit është shumë i rëndësishëm dhe nga dorëheqja e tij varet edhe fati i qeverisë, sa se nëse ai largohet edhe qeveria bie (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008).

Kryeministri i Republikës së Kosovës përfaqëson qeverinë në raport me institucionet tjera. Ai është ideatori i konceptit për drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme të vendit.

Është përgjegjës dhe për bashkërendimin e punës së resorëve ministror por njëkohësisht edhe kontrollon punën e ministrave dhe institucioneve të tjera qeveritare.

Kryeministri i qeverisë së Republikës së Kosovës ka edhe kompetenca në emërimin e udhëheqësve të agjencive të ndryshme si është emërimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës ndërsa së bashku me Presidentin, emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.

Ndërsa sa i përket politikës së jashtme kompetencat e tij lidhen me Presidentin e vendit, sepse për zbatimin e politikave të jashtme ai paraprakisht duhet të konsultohet me Presidentin.

3.2.2 Ministrat në Qeverinë e Republikës së Kosovës

Ministrat e qeverisë së Kosovës udhëheqin dhe janë përgjegjës për resorët përkatëse të qeverisë. Ata drejtojnë ministratë e tyre, brenda politikës së përgjithshme shtetërore, dhe merren ekskluzivisht me veprimtarinë që ka në kompetencë në ministrinë që ata udhëheqin. Ata përfaqësojnë institucionin që drejtojnë në raport me institucionet tjera. Zgjedhja e ministrave të qeverisë së Kosovës bëhet pas konsultimit me partitë politike, koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetin.

Ministratë si organe administrative të pushtetit nxjerrin akte normative të cilat, janë të detyrueshme për zbatim nga hallkat tjera më të ulëta të pushtetit ekzekutiv, me anë të të cilave vendosin rregulla sjelljeje për gjithë administratën publike, faktikisht i japin drejtimin politik pushtetit ekzekutiv. Aktualisht qeveria e Kosovës numëron 19 Ministri. Edhe përkundër faktit se janë hartuar dy projekt drafte, qeveria e Kosovës ende nuk ka ligjin për qeverinë (GAP, Analizë politikash, 2011).

4. Pushteti gjyqësor

Shikuar nga aspekti teorik dhe formalo juridik Republika e Kosovës ka të konsoliduara institucione shtetërore të cilat veprojnë mbi bazën e ndarjes së pushteteve. Një gjë e tillë është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kurse ligjet bazike për sistemin gjyqësor dhe prokurorial janë të aprovuara në vitin 2010. Këtu hyjnë: Ligji për Gjykatat, Ligji për Prokurorin e Shtetit, Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, dhe Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Faktikisht deri në aprovimin e këtyre ligjeve bazike të lartcekura, sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës ka pas disa pengesa dhe probleme edhe në aspektin formalo juridik, probleme këto që tregojnë për ndikimin e pushteteve tjera në reformimin e mirëfilltë të sistemit të drejtësisë. Këtu do të mund të përmendëj për shembull procesi i emërimit dhe ri-emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve kishte filluar në shkurt të vitit 2009 para se të krijoheshin kushtet e favorshme të punës nëpër gjykata dhe prokurori pasi që ligjet bazike që përmendem me lartë do të aprovoreshin një vit më vonë tek në gusht dhe tetor 2010 (KIPRED Analizë e pavarësisë së pushtetit gjyqësor në Kosovë, 2011).

Ndërsa nëse dëshirojmë të trajtojmë çështjen nga aspekti praktik do të vërejmë se në punën dhe sidomos në pavarësinë e sistemit gjyqësor të Kosovës mbetet ende shumë për tu dëshiruar. Kjo nga fakti se në shumë raste gjyqësia në Kosovë përballet me probleme nga më të ndryshmet duke filluar nga baza jo e mjaftueshme ligjore për luftimin e dukurive negative, problemet me personelin e kualifikuar dhe profesional për trajtimin e sfidave me të cilat përballet sot sistemi gjyqësor në botën bashkëkohore, pastaj mungesa e mjeteve materiale dhe financimit të projekteve që do të ndikojnë në përmirësimin e kushteve të punës etj. Në këtë aspekt vlerësimi jo të kënaqshëm për gjyqësorin në Kosovë bëjnë edhe organizatat e huaja që merren me vlerësimin e punës së sistemit gjyqësor. Një i tillë është edhe raporti i Demokratizimit të Komizës dhe Pavarësisë Gjyqësore për vitin 2011, i organizatës Freedom House për Kombet në Tranzicion. Kosova në këtë raport është vlerësuar me notën 5.75, ku 1 është vlera më e lartë, ndërsa 7 vlera më e dobët (Freedom House, Kombet në Tranzicion, 2011).

Nëse kësaj i shtohet edhe fakti se gjatë periudhës së administrimit ndërkombëtar nuk vërehet ndonjë përparim i theksuar por me tepër do të mund të ishte cilësuar si ngecje e zhvillimit të sistemit gjyqësor, atëherë del një fotografi paksa më e qartë e kësaj fushe. Ajo që vërtetë do të mund të atribuohet si sukses i bashkësisë ndërkombëtare në sistemin gjyqësor të Kosovës është insistimi i vazhdueshme në aplikimin e konventave dhe normave tjera afirmative ndërkombëtare që ndikojnë për të arritur në një stad të akceptueshëm të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, si dhe të ngritjes së një sistemi gjyqësor drejt përafrimit të sistemeve të përparuara gjyqësore të vendeve demokratike.

4.1 Organizimi dhe funksionimi i Gjykatave

Pushteti Gjyqësor në Kosovë është i pavarur, unik dhe ushtrohet nga Gjykatat, ndërsa gjykatësit duhet të jenë të pavarur në ushtrimin e funksionit të tyre. Çdo njërit i garantohet e drejta e ankesës sipas ligjit. Gjyqtarët i emëron, rriemëron dhe shkarkon Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për një mandat të parë trevjeçar dhe në raste të rriemërimit, mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit, dhe ata janë të privuar të ushtrojnë ndonjë funksion në institucionet shtetërore jashtë gjyqësorit. Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësisë të tyre (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008).

Në Republikën e Kosovës sistemi gjyqësor njih tre lloje gjykatash:

Gjykata Themelore si gjykate e shkallës së parë. Në Kosovë ekzistojnë shtatë Gjykata themelore të cilat kanë edhe degët e veta. Dhe që kanë kompetencë të gjykojnë në shkallë të parë gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe (Ligji për Gjykatat, 2010).

Gjykata e Apelit si gjykate e shkallës së dytë ka selinë në Prishtinë dhe ka juridiksion territorial në tërë Kosovën. Gjykata e Apelit është kompetente të vendos për të gjitha ankesat e ushtruara kundër vendimeve të Gjykatave Themelore, por edhe si gjykatë e shkallës së tretë (Ligji për Gjykatat, 2010).

Gjykata Supreme e Kosovës është instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë dhe ka juridiksion në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Është kompetente të vendosë lidhur me kërkesën për mjetet e jashtëzakonshme juridike, revizionin kundër vendimeve të shkallës së dytë, jep mendimet juridike për çështjet që kanë rëndësi për zbatimin unik të ligjeve, si dhe çështje të tjera të parapara me ligj (Ligji për Gjykatat, 2010).

Organizatrat ndërkombëtare me kapacitet ekzekutiv që operojnë në Kosovë

Në Republikën e Kosovës kemi një fenomen unik, i cili ndoshta rrallë mund të gjendet në shtete të tjera të botës. Madje ky fenomen përshkruhet me një kolorit kompleks të ushtrimit të pushtetit shtetëror. Në këtë rast format klasike përkatësisht tradicionale të ushtrimit të pushtetit shtetëror bëjnë përjashtim, sepse në Kosovë një pjesë të pushtetit ekzekutiv e ushtrojnë edhe disa organizata ndërkombëtare, të cilat kush më shumë dhe dikush me pak kanë të autorizime ekzekutive në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Madje edhe atje ku organet ekzekutive të pushtetit të Republikës së Kosovës nuk arrijnë të shtrijnë pushtetin e tyre. Ajo çfarë e bën pushtetin e tyre edhe me të rëndësishëm është edhe fakti se pushtetit të tyre është i njohur edhe nga bashkësia ndërkombëtare, jo vetëm nga shtetet që kanë njohur qeverinë e Kosovës por edhe nga ato shtete të cilat ende hezitojnë të njohin qeverinë legjitime të Republikës së Kosovës. Këtu në radhë të parë është fjala për forcat ndërkombëtare ushtarake që në Kosovë kanë rolin paqeruajtës dhe që njihen me shkurtesën KFOR, por fuqi të caktuara ekzekutive në zbatim të ligjit ka edhe misioni i Bashkimit Evropian i cili njihet me shkurtesën EULEX, pastaj ish-Zyra Civile Ndërkombëtare e njohur me shkurtesën ICO, misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara i njohur me shkurtesën UNMIK.

KFOR, ka për detyrë që në përputhje me Rezolutën 1244, në Kosovë të krijojë dhe të mbajë një ambient të qetë dhe të sigurt, duke përfshirë sigurinë dhe rendin publik, që me këtë kupton se KFOR ka edhe autorizime të përdor forcë nëse është e nevojshme vendosja e rendit publik. KFOR-i gjithashtu monitoron, verifikon dhe mund të përdor edhe forcë nëse kjo do të jetë e nevojshme, për të zbatuar Marrëveshjen Tekniko-Ushtarake të Kumanovës, përmes të cilës është arritur tërheqja e forcave ushtarake Serbe nga Kosova. Kjo na bën me dije se KFOR ka autoritet të bëjë mbrojtjen e integritetit territorial të Kosovës, e që në fakt lidhet drejtpërdrejtë me sovranitetin shtetëror të Kosovës. (<http://www.nato.int/kfor/docu/about/objectives.html>, 19:09/2012:14:10).

EULEX, është misioni ndërkombëtar i Bashkimit Evropian, që përpos kompetencave ekzekutive policore dhe doganore, bën edhe zgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë si dhe vendosë se cilat raste do t'i gjykojnë ata dhe cilat mbesin kompetence e gjykatave vendore. EULEX-i ka të drejtë të shpallë të pavlefshme vendimet e qeverisë së Kosovës dhe institucioneve të tjera por edhe të marrë përsipër përgjegjësi të tjera, në mënyrë të pavarur ose në mbështetje të autoriteteve kompetente të Kosovës (<http://www.eulex-kosovo.eu/en/front/>, 20:09/2012:12:10).

ish-ICO, ose ish, Zyra Civile Ndërkombëtare (ish-ZCN) ishte autoriteti përfundimtar për interpretimin dhe zbatimin e Planit të Ahtisarit, e që është de facto dokumenti përmes të cilit u arrit pavarësia e Kosovës, deri në përfundimin e mbikëqyrjes nga ish-Zyra Civile Ndërkombëtare (<http://www.dw.de/kuvendi-i-kosov%C3%ABs-miraton-fundin-e-mbikqyrjes-nd%C3%ABrkomb%C3%ABtare/a-16225293.25.112014.18:30>). Përveç miratimit të disa pozitave kyçe në institucionet e Kosovës, kjo zyre ka pasur edhe fuqi ekzekutive e korrigjuese për vendime të ndryshme. Këto fuqi kanë qenë shume të mëdha dhe në raste të caktuara, dhe mund të përfshinin, por nuk kufizoheshin me anulimin e ligjeve ose vendimeve të marra nga Kuvendi i Kosovës për të cilat kjo zyrë vlerësonte se eventualisht kishin shkelur ose ishin në kundërshtim me Marrëveshjen përkatësisht planin e ish presidentit Finlandez z. Marti Ahtisari, apo sundimin e ligjit në vend. Ish-përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar i cili ishte udhëheqësi me i lartë i kësaj zyre ka pasur autoritet të dënojë ose shkarkojë nga pozita cilindo zyrtar publik, nëse ai vlerësonte se zyrtari i lartcekur ka kundërshtuar frymën e Marrëveshjes ose në ndonjë mënyrë ka penguar punën e ish-ZCN-se apo EULEX-it (<http://www.ico-kos.org/?id=8>, 20:09/2012:12:25).

UNMIK, është misioni ndërkombëtar që u vendos në Kosovë në vitin 1999, me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit, dhe i autorizuar nga Sekretarin e Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për të vendosur një prani ndërkombëtare civile në Kosovë, me qëllim që të sigurojë një administrim të përkohshëm për Kosovën. Në fillim të instalimit të tij, UNMIK-u nën autoritetin e Këshillit të Sigurimit kishte autorizime të plota mbi territorin dhe popullin e Kosovës, duke përfshirë të gjitha fuqitë legjislative dhe ekzekutive, si dhe administrimin e gjyqësorit.

MirëpopashtpalljessëpavarësisëngaautoriteteteKosovësdhehyrjesnëfuqitënjëkushtetutetëremë15qershor2008,detyrate misionitjanëmodifikuar në mënyrëtëkonsiderueshme dhe UNMIK kryesisht përqendrohet në promovimin e sigurisë, stabilitetit dhe respektit për të drejtat e jeriut në Kosova. (<http://www.un.org/en/peacekeeping/missions/unmik/index.shtml>, 20:09/2012:15:00).

6. Konkluzion

Parimet klasike të sovranitetit shtetëror nënkuptojnë atë formë të pushtetit shtetëror ku i tërë pushteti shtetëror është i koncentruar në organet supreme të pushtetit shtetëror që formon dhe mbikëqyrë edhe të gjitha format e tjera të pushtetit në një territor të caktuar. Dhe në një formë ushtron pushtetin e përgjithshëm mbi territorin e caktuar. Por në ditët e sotme ky lloj sovraniteti pothuajse as nuk ekziston më, madje as si koncept teorik nuk mund të aplikohet, posaçërisht jo në demokracitë moderne kur me hyrjen dhe integrimin vullnetar në organizata të caktuara përmes marrëdhënieve ndërkombëtare delegohet edhe një pjesë e sovranitetit, dhe merren përgjegjësi të caktuara të cilat drejtpërdrejtë ose tërthorazi prek, dhe ngushtojnë çështjet që lidhen me sovranitetin shtetëror.

Por, Republika e Kosovës përveç çështjes që trajtoam më lartë, kur me hyrjen ose integrimin e vullnetshëm në një organizatë ndërkombëtare delegohen edhe disa përgjegjësi që kanë të bëjnë me sovranitetin shtetëror të një vendi. Natyrisht kjo bëhet gjithnjë për interesat e rëndësishme shtetërore dhe kombëtare dhe me qëllim afirmativ. Por në Republikën e Kosovës ka edhe disa probleme të brendshme të cilat ndikojnë që organet e pushtetit të mos jenë në gjendje të ushtrojnë sovranitetin shtetëror në të gjitha pjesët e territorit. Në Republikën e Kosovës, përkatësisht në komunat veriore të vendit të cilat banojnë kryesisht më popullatë Serbe, organet e pushtetit ende nuk kanë arritur të ushtrojnë pushtetin e vet, madje për të qenë edhe me brengosëse gjendja, në këtë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës veprojnë ende struktura të organizuara dhe organe ilegale të pushtetit të Republikës së Serbisë. Këto organe dhe struktura janë të mirë organizuara si në fushën e administratës publike ashtu edhe në atë të sigurisë, shëndetësisë, arsimit, organizimit dhe mbajtës së zgjedhjeve etj. Kjo të bën që më të drejtë të shtrohet pyetjen: Sa është vërtetë Republika e Kosovës sovraane në të gjithë territorin e saj?

Përderisa Republika e Kosovës për shkak të mosnjohjes ndërkombëtare të pavarësisë nga disa vende ende nuk është në fazën e hyrjes apo integritimit në organizatë ndërkombëtare qoftë të karakterit rajonal apo global, ku do duhej të delegojë disa përgjegjësi të cilat lidhen me sovranitetin shtetëror. Po ajo ka edhe një element të brendshëm i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndikon në ushtrimin e pushtetit shtetëror përkatësisht ushtrimin të sovranitetit shtetëror, ose pavarësisë së plotë në ushtrimin e sovranitetit shtetëror. Këtu është fjala për organizatat ndërkombëtare prezentë me autoritet të pushtetit ekzekutiv në Kosovë, të cilat siç pamë edhe në tekstin më lartë kanë pushte ekzekutiv, madje edhe të anulimit të akteve normative të rëndësishme për popullin e Kosovës. Pushtet ky i cili është i njohur ndërkombëtarisht.

Bibliografia

- Aktiviteti legjislativ i Kuvendit të Kosovës, Shkurt deri në Dhjetor 2011, Kuvendi i Kosovës, Prishtinë.
Benoist A. (1999), "What is the sovereignty", Toles .
Dalton D. (1998), "Power over people : Classical and modern theory", The teaching company.

- GAP Instituti për Studime të Avancuara, “Analizë politikash”, 2011, Prishtinë.
- KIPRED Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave, “Analizë e pavarësisë së pushtetit gjyqësor në Kosovë”, 2011, Prishtinë.
- Lipušček U. (2008), Presented at First International Conference- Freedom and Democracy: “Perceptions, European Perspectives”, Faculty of Humanities Koper, University of Primorska.
- Ligji për Gjykatat, 2010, Aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.
- Kushtetuta e Kosovës 2008, miratuar nga Kuvendi i Kosovës.
- Freedom House, 2011, Kombet në Tranzicion, Raporti i Demokratizimit të Kornizës dhe Pavarësisë Gjyqësore.
- Pushteti në Kosovën e pas pavarësisë, 2009, Instituti Demokratik i Kosovës, Prishtinë.
- Korniza Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, 2001.
- <http://legal-dictionary.thefreedictionary.com/>
- <http://kosova.org/post/Lista-e-shteteve-qe-kanë-pranuar-pavaresinë-e-Kosovës>
- <http://www.ncsl.org/legislatures-elections/legislatures/delegation-of-legislative-power.aspx>
- <http://www.kdi-kosova.org/publications/cimap/kpp.pdf>
- <http://www.nato.int/kfor/docu/about/objectives.html>
- <http://www.eulex-kosovo.eu/en/front/>,
- <http://www.ico-kos.org/?id=8>
- http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_ko_119_14_shq.pdf
- <http://www.dw.de/kuvendi-i-kosov%C3%ABs-miratton-fundin-e-mbikëqyrjes-nd%C3%ABrkomb%C3%ABtare/a-16225293>

BARAZIA GJINORE NË PUNË NË TË DREJTËN EVROPIANE

SKERDILAJD BAJRAMAJ

Specialist Kabineti, Shoqëria KESH Sh.A

Email: skerdibajramaj@yahoo.com

ABSTRAKT

Studimi ka si objekt direktivat, konventat dhe rekomandimet e Komunitetit Evropian duke marrë parasysh se përfshinë në të edhe të gjitha direktivat e mëparshme të Komunitetit Ekonomik Evropian (EEC); a) mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë si për burrat dhe gratë për sa i përket punësimit, trajnimit profesional, promovimit dhe kushtet e punës, b) mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave në fushën e sigurisë në punë sociale, c) mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me zbatimin e parimit të pagesës së barabartë si për një mashkulli dhe një femre dhe d) mbi barrën e provës në rastet e diskriminimit në bazë të gjinisë.

Për këtë qëllim, analiza e këtij studimi do të fokusohet në pjesën e zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë sa i përket qasjes në punësim, trajnim dhe promovim profesional dhe kushtet e punës.

Më tej do të kalohet në një analizë të thelluar të praktikave të BE-së, duke përkujtuar evolucionin që ka pasur parimi i mos diskriminimit në traktatet themeluese të Komuniteteve. Në aspektin e qasjes në tregun e punës, trajtimit në punë dhe shpërblimit. Në mënyrë më të detajuar janë analizuar efektet dhe ndikimi që kanë pasur këto parime dhe norma të së drejtës ndërkombëtare në tranzicionin e legjislacionit të vendit tonë, si në kuadër të nënshkrimit të traktateve që lidhen me këtë fushë ashtu edhe rrugën drejt anëtarësimit të plotë në strukturat e Bashkimit Evropian. Në fund do të nxirren disa konkluzione mbi përshtatshmërinë e normave dhe praktikave ndërkombëtare në realitetin shqiptar.

Fjalë kyç: *Marrëdhënie Pune, Diskriminim, trajtim i barabartë*

1. Hyrje

Parimi i mos diskriminimit ka lindur si një mjet për të shmangur prishjen e konkurrencës, duke u shndërruar më pas në një element të rëndësishme për zbatimin e politikave të Komunitetit Evropian, ndërsa nga ana tjetër parimi i barazisë, rivlerësohet në të ashtuquajturat dispozita sociale të Traktatit K.E. në aspektin e qasjes në tregun e punës, trajtimin në punë dhe shpërblimit.

Ndalimi i diskriminimit mbi bazën e kombësisë, përcaktuar në nenin 12, përbën një element thelbësor në krijimin e tregut të brendshëm dhe siguron funksionimin përmes dispozitave të shumta të Traktatit, duke mos qenë një klauzolë që prodhon automatikisht të drejta, por ja delegon dispozitave të tjera.

Mund të themi se ndalimi i diskriminimit në bazë të kombësisë nuk ka pësuar ndryshime thelbësore në vijim të reformave të ndërmarra nga Traktatet. Ndryshimi i vetëm qëndron në paragrafin 2, të neni 12, sipas të cilit është e mundur të merren vendime në përputhje me procedurën e bashkëvendimit, ndërsa me para Këshilli vendoste duke përdorur procedurën e bashkëpunimit.

Parimi i barazisë në BE-së është i trajtuar ndryshe nga sa ndodh në rendet ligjore të secilit shtet anëtar. Në këto të fundit, gjykimi bëhet nga gjyqtari lidhur me thelbin e barazisë, që zakonisht është një kontroll që kërkon të verifikojë argumentimin e drejtë të normave që paraqesin diferencime. Në planin Komuniteti, gjykimi mbi barazinë qëndron në verifikimin që u bëhet akteve normative për përputhshmërinë me kriteret specifike të mos-diskriminimit.²

Sipas një teorie tjetër zbatimi i parimit të barazisë në hapësirën e Komuniteti Evropian ndryshon në varësi të faktit nëse ata shqyrtojnë aktet e institucioneve të Komunitetit apo aktet e brendshme të vendeve anëtare që ndikojnë në katër liritë themelore.

2. Analizë dhe interpretim aktesh dhe faktesh juridike

a. Parimi i mos diskriminimit

Parimi i mos diskriminimit është një nga parimet themelore të BE-së dhe është e ndarë në dy ndalime të ndryshme: a) ndalimi i çdo diskriminim që bazohet te kombësia, nenin 12 i Traktatit të KE-së; dhe b) parimi i mos diskriminimit ndërmjet burrave dhe grave parashikuar nga neni 141³, në zonën e kufizuar të barazisë së pagës që ka pësuar një zhvillim të madh në dekadat e fundit.

Edhe pse ka lindur si një garanci më shumë për mirëfunksionimin e tregut të brendshëm⁴, parimi i barazisë midis burrave dhe grave u kufizua nga hartuesit e Traktateve, në aspektit e ngushtë të pagës në vendin e punës; në të njëjtën kohë, u zgjodh që ti transferohej vendeve anëtare barrën për tu kujdesur për zbatimin e parimit.

Gjithashtu, në Traktatin e Romës të vitit 1957, nuk parashikohej një ndalim i përgjithshëm i diskriminimit, por vetëm një ndalim me natyrë të përgjithshme mbi kombësinë, dhe një fragmentim i llojeve të tjera të diskriminimit, që përkonin me zonat e kompetencës së transferuara Komunitetit Evropian.

Edhe pse neni 141 parashikon parimin e pagesës së barabartë për punëmarrësin burrë me punëmarrësen grua për të njëjtën punë, rrezja e veprimit ishte shumë e ngushtë pasi objektivi kryesor nuk ishte barazia në pagë mes burrit dhe gruas por trajtimi i barabartë për të evituar efektet e pandershme shoqërore në tregun e brendshëm komunitar.

Pavarësisht krijimit të saj nisur nga nevoja të caktuara ekonomike, interpretimi i neni⁵ dhe akteve zbatuese ka ndryshuar shumë me kalimin e kohës, kështu që parimi i barazisë së pagës është shndërruar në mjetin për të kërkuar barazinë e të drejtave të punëtorëve femra në veçanti dhe më vonë i femrave në përgjithësi. Shtetet anëtare të Komunitetit, në atë periudhë nuk kanë parashikuar zbatimin e parimit të barazisë së pagës brenda fazës së parë, siç parashihet në nenin 141, duke bërë Gjykatën e Drejtësisë të përmbushë këtë lakun normative të krijuar.

Në këtë mënyrë neni 141 i drejtohet vetëm shtetet anëtare të Komunitetit, dhe më konkretisht pushtetit të brendshëm legjislativ të cilët kishin detyrimin⁶ të adoptonin masat më të efektshme për të garantuar zbatueshmërinë brenda rendeve të secilit shtet anëtar, e të drejtës së barazisë në page për punonjësit e gjinive të ndryshme por që kryejnë të njëjtin proces pune.

¹ P.sh. ne lidhje me punëtorët: neni. 48, lëvizja e lirë e punonjësve; neni 52, liria e vendqëndrimit; neni 59 liria për të ofruar shërbime; neni 40, për diskriminim ndërmjet prodhuesve ose Konsumatorët në Komunitet; etj.

² Shih Strazzari D. "Discriminazione razziale e diritto- un'indagine comparata per un modello europeo dell'ntidiscriminazione, Cedam, 2008, f. 217.

³ Neni 114 sanksiononte që "secili shtet anëtar duhet të sigurojë zbatimin e parimit e pagesës së barabartë për burrat dhe gratë për një punë të barabartë ose punë me vlerë të barabartë".

⁴ Shih Martin D., "Discriminations", "entraves" et "raion imperieuses dans le Traité CE: trois concepts et quête d'identité", te Cahiers de droit européen, 2008, f. 263

⁵ "Çdo shtet anëtar do të sigurojë gjatë fazës së parë aplikimin e parimit të pagesës së barabartë për burrat dhe gratë për të njëjtin shërbim pune të ofruar. Në baze të këtij neni, me pagese do të kuptohet rroga ose shpërblimi të paguar drejtpërdrejt ose tërthorazi, në para ose në natyrë, nga punëdhënësi për punëtorin, për shkak të punës së këtij të fundit. Pajesa e barabartë, pa diskriminim në bazë të gjinisë, nënkupton: a) që të paguajnë për të njëjtën kohë punë.

⁶ duhet të llogaritet bazuar në të njëjtën njësi matëse; b) që pagesa për punën me kohë të caktuar të jete e njëjtë për të njëjtën punë ". "Transformimi i

b. Te rejat që solli Direktiva nr. 76/207/KEE

Nga mesi i viteve shtatëdhjetë, pas krizës ekonomike, Komuniteti Evropian ka punuar me intensitet për të vënë në zbatim nenin 141. Si fillim u bë miratimi i Direktivës nr. 75/117 të Këshillit, me qëllim përafrimin e legjislacioneve të shteteve anëtare për zbatimin e parimit të barazisë të pagesës dhe Direktivës nr. 76/207, që kishte si synim zbatimin e trajtimit të barabartë në punësim, trajnim dhe promovim profesional dhe të kushteve punës.

Nga ana e saj, Direktiva nr. 75/117 rithekson parashikimet e nenit 141 duke ju treguar në mënyrë të detajuar shteteve anëtare se si të përshtatin legjislacionin e tyre të brendshëm me parimin e pagesës së barabartë, duke ju përcaktuar dhe afatin kohor brenda të cilit duhej kryer.

Direktiva 76/207 ndryshe nga Direktiva nr. 75/117 nuk ka si objekt përafrimin e legjislacioneve të shteteve anëtare, por përbën një dispozitë të veçantë për këtë fushë.

Gjithashtu, edhe objekti i direktivës është i ndryshëm, pasi akti synon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrit dhe gruas për sa i përket procesit të punësimit, për aftësimin profesional dhe promovimin si dhe kushtet e punës⁷. Direktiva nr. 76/207 i kushton një vëmendje të veçantë aspekteve të marrëdhënies së punës ku rëndësi të veçantë ka parimi i trajtimit të barabartë në punësim, në formimin profesional dhe largimin nga puna⁸.

Një tjetër tipar i ri që meriton vëmendje është baza ligjore e direktivës që ndryshon: kjo e fundit nuk mbështetet më në nenin 119, duke qenë se direktiva nuk trajton më vetëm çështjen e pagës së barabartë, por edhe elemente të tjera shtesë që nuk parashikohen në nenin 119 siç është punësimi, trajnimi profesional dhe kushtet e punës.

Si bazë ligjore, në gjendje për të justifikuar qëllimin e gjerë të direktivës, është përdorur neni 308 i Traktatit, në të cilën bazohet edhe teoria e forcave të nënkuptuara. Sipas saj “kur Komuniteti gjykon se një veprim është i nevojshëm për të arritur, në funksionimin e tregut të përbashkët, një nga qëllimet e Komunitetit, duke vendosur unanimisht mbi një propozim të Komisionit dhe pas këshillimit me Parlamentin Evropian, të marrë masat e duhura”. Përdorimi i kësaj dispozite ka pasur një vlerësim të gjerë duke filluar nga Samiti i Paris i vitit 1972, duke mundur një forcim dhe një zgjerim të kompetencave të Komunitetit në shumë drejtime të ndryshme. Pas hyrjes në fuqi të Aktit Unik, Komisioni ka tentuar të bllokojë përdorimin e nenit 308 K.E. për të parandaluar rikthimin në praktikë të ashtuquajturës Marrëveshja e Luksemburgut; në të njëjtin drejtim ka lëvizur edhe Gjykata e Drejtësisë duke deklaruar se përdorimi i nenit aktual 308 si baza ligjore për një akt është e justifikuar vetëm atëherë kur nuk ka dispozitë tjetër të Traktatit që ti japë institucioneve të Komunitetit kompetencat e nevojshme për të miratuar këtë akt (C-45/86).

Pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Mاستrihitit neni 308 vazhdon të jetë një element i rëndësishëm në funksionimin e Komunitetit pasi vazhdohet të kihet si referim për arritjen e qëllimeve të reja të Komunitetit, madje edhe në mungesë të kompetencave të nevojshme.

Gjykata Evropiane me opinionin 2/94 ka pasur rastin për të theksuar se neni 308 “ka për qëllim të mbështesë, në mungesë të kompetencave për të vepruar të dhëna shprehimisht ose tërthorazi institucioneve të Komunitetit nga dispozitat e veçanta të Traktatit, kur kompetenca të tilla duhet të kishin dalë për të mundur që Komuniteti të kryej detyrat e tij me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara nga Traktati. Dispozita, duke qenë pjesë përbërëse e një sistemi institucional të bazuar në parimin e kompetencave të deleguara, nuk mund të shërbejë si bazë për zgjerimin e fushës së kompetencave të Komunitetit përtej fushëveprimit të kornizës së përgjithshme të krijuar nga dispozitat e Traktatit dhe në veçanti të atyre që përcaktojnë detyrat dhe veprimtarinë e Komunitetit.

Gjithsesi, nuk mund të përdoret si bazë për miratimin e dispozitave që prodhojnë në thelb një modifikim të Traktatit, duke shmangur procedurën e përcaktuar nga vetë Traktati të për këtë qëllim.

Në Traktat vihet re një mungese e parashikimit të të drejtave për të vepruar për këtë qëllim, nga këtu dhe përdorimi i mëvonshëm i nenit 235 si bazë ligjore e aktit. Përveç futjes së elementeve të reja, Direktiva nr. 76/207 ka meritën e hapjes së një faze intensive të prodhimit të legjislacionit të Komunitetit, në bazë të nenit 235 me qëllim zgjerimin e parimit të barazisë nga aspekti i diskriminimit në pagë në shumë aspekte të tjera të marrëdhënies së punës.

Hyrja e Direktivës thekson se: “trajtimi i barabartë si për punëtorët burra ashtu edhe për ato gra, përbën një nga objektivat e Komunitetit”, dhe zbatimin e tij, duke përfshirë edhe qasjen në punësim, duke përfshirë promovimin, dhe siguri sociale, si edhe kushtet e punës, përbën edhe qëllimin e vetë direktivës. Mirëpo, menjëherë pas kësaj, ligjvënësi evropian precizon se parimi i trajtimit të barabartë nënkupton mungesën e çdo diskriminimi, qoftë i drejtpërdrejtë apo i tërthortë, i bazuar te gjinia, me disa përjashtime. Kjo Direktivë nuk cenon masat për të promovuar mundësi të barabarta për burrat dhe gratë, në veçanti duke hequr pabarazitë ekzistuese që cenojnë mundësitë e grave në fushat e përmendura në paragrafin 1, neni 1. Disa studiues theksojnë se rrjedhim i këtij interpretimi është fakti se masat duhet të vlerësohen në dy këndvështrime: a) njeri strukturor dhe ka të bëjë me dobishmërinë e saj për të rregulluar diskriminimin praktik që ndikojnë në mundësitë e grave; b) tjetri, teorik, që lidhet me funksionin e saj për të nxitur shanset e barabarta.

Direktiva duke mos dashur të precizojë me saktësi instrumente ligjore në dispozicion të zbatimit të barazisë thelbësore ndërmjet punëtorëve meshkuj dhe femra ka shtyrë Gjykatën e Drejtësisë të kryej rolin e promotorit në gjetjen e mënyrës për balancimin e interesave të punëtorëve femra në raport me kompanitë dhe në marrëdhëniet me kolegët meshkuj të punës.

Në këtë fazë është miratuar: Direktiva e Këshillit nr. 79/7 për fushën e sigurisë shoqërore; Direktiva nr. 86/378 Për barazi në sigurinë në punë sociale; Direktiva nr. 86/613 për çështjet e vetëpunësimit dhe amësisë; dhe Direktiva nr. 92/85 për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtorëve shtatzëna që kanë lindur ose janë me fëmijë në gj.

⁸ Edhe qasja gjuhësor ka ndryshuar: ne nuk flasim për punëtorët meshkuj dhe femra, por për burra dhe gra. Shih Nani L., “Uguaglianza tra lavoratori e lavoratrici nel rapporto di lavoro”, ne Dir. Lav., 1998, f. 358;

Në këtë rast duket sikur qëndrimi i Gjykatës deklaron paligjshmërinë e akteve pozitive “inkurajuese” të cilat mënjanojnë që në burim pengesat të cilat dëmtojnë gratë¹⁰. Pikëpamje të ndryshme në këtë rast ka shprehur doktrina franceze¹¹, sipas së cilës, në Francë me përjashtim të legjislacionit për mbrojtjen e shtatzënisë dhe amësisë, ka një tentative për të legjitimuar masa të veçanta, që zbatohen për gratë në emër të shanseve të barabarta, por që në shumicën e rasteve këto janë masa që bëjnë pjesë në një logjikë të ndarjes së roleve që për një kohë të gjatë ka frymëzuar politikën franceze dhe se pas zbatimit të Direktivës nr. 76/207 nuk është më e pranueshme. Studiuesit franceze e shpjegojnë këtë “rezistencë” që shfaq Franca ndaj praktikës gjyqësore të Komunitetit si një fenomen që i kanë rrënjët në perceptimin ‘atëror’ të barazisë që fillon nga ideja se gruaja është një qenie psikologjikisht më e dobët, dhe që duhet të këtë një rol parësor brenda familjes. Në fakt, në kohën e transpozimit të Direktivës nr. 76/207 legjislacioni francez nuk parashikonte krijimin e veprimeve pozitive në favor të grave.

Duke ju kthyer analizës së Direktivës nr. 76/207, do të thosha se ajo që i ka mundësuar Gjykatës të lëvizte në një zonë të tillë të ndjeshme është dispozita sipas së cilës: “kjo direktivë nuk cenon masat e marra për të promovuar shanset e barabarta për burrat dhe gratë, në veçanti duke hequr pengesat ekzistuese që ndikojnë në mundësitë e punësimit të grave në sektorët përkatës, duke përfshirë promovimin dhe qasjen në trajnim profesional, kushtet e punës dhe sigurimit social.

Në këtë periudhë edhe institucionet e Komunitetit fillojnë të bëhen më të ndjeshme ndaj kësaj çështjeje. Për tu theksuar është rekomandimi i Këshillit të Ministrave të KE ne 1984¹² nga i cili pasqyrohet një pamjaftueshmëri e përgjithshme e dispozitave normative në temat e trajtimit të barabartë, të pozicionuara në mënyrë kryesisht mohuese, d.m.th. si ndalim për të diskriminuar, të cilat në vetvete nuk janë në gjendje të eliminojnë pabarazinë reale, por që duhet të mbështeten nga veprime paralele të ndërmarra nga qeveritë e vendeve anëtare dhe palëve të interesuara, ajo çfarë ne sot quajmë shoqëria civile, si kundërpeshë ndaj efekteve negative që rezulton për gratë, në fushën e punësimit, qëndrimeve dhe sjelljeve diskriminuese tanimë si pjesë e integruar në strukturat e shoqërisë.

Rekomandimi në fjalë, përveç kësaj, ka përcaktuar veprimet e mëtejshme legjislative të tilla si forcimi i aktivitetit për të siguruar respektimin e parimit të trajtimit të barabartë, promovimin e barazisë de facto të mundësive përmes adoptimit, si në aspektin e Komunitetit ashtu edhe atë brendshëm, të sistemeve të trajtimit të privilegjuar në fusha të tilla si pagesës të barabartë, trajtimit të barabartë për sa i përket hyrjes në punë, trajnimeve, promovimit profesional, dhe kushtet e punës; duke ftuar shtetet anëtare që të mundësonin përfshirjen në aktet pozitive “nxitjen, promovimin dhe marrjen në punë të kandidateve gra në fushat profesionale dhe në nivele ku ato janë të nën-përfaqësuara, veçanërisht në pozicionet drejtuese”.

c. Ndryshimet e sjella nga Traktati i Amsterdimit

Fillimi i vitet ‘80 të shekullit të kaluar është karakterizuar nga një qasje e ndrojtur nga ana e institucioneve të KE-së për çështjen e trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë. Së pari, fill pas krizës industriale të viteve 70, përballë rritjes së papunësisë dhe të inflacionit, u bë e qartë se harmonizimi i plotë dhe barazimi nga lart i sistemeve sociale ishte bërë një objektivi i pa arritshëm. Akti Unik paraqet një bazë të re ligjore në aspektin e politikës sociale duke ndryshuar nenin 137 ECT dhe parashikuar përdorimin e mënyrës së votimit të kualifikuar, që braktis idenë e “harmonizimit në vijim” dhe zëvendësimin e saj me krijimin progresiv të kërkesave minimale. Prandaj harmonizimi minimal është i shkëputur përfundimisht nga ideja e kërkimit të barazisë në rezultatet mbrojtëse të sistemit social më të avancuar¹³.

Këtyre viteve ju përkasin si programi i parë i veprimit të Komunitetit (1982- 1985) ashtu dhe i dyti (1986-1990), me të cilët janë specifikuar objektivat që duheshin arritur për barazimin e shanseve që është: konsolidimi i zbatimit të direktivave, adoptimi i teknikave të reja të Komunitetit dhe rishikimi i legjislacionit në fuqi. Është miratuar gjithashtu edhe rekomandimi “për promovimin e veprimeve pozitiv në favor të grave”, i cili u përshëndet edhe pse me perceptimin e saktë se ndërhyrja e KE-së nuk ishte ende në gjendje të ndikojë konkretisht në drejtimin e politikës së brendshme.

Po atyre viteve i takon dhe miratimi i Kartës së Komunitetit për të Drejtat Sociale Themelore të Punonjësve¹⁴. Neni 16 i të cilit parashikon se “trajtimi i barabartë midis burrave dhe grave duhet të jetë i garantuar. Shanset e barabarta ndërmjet burrave dhe grave duhet të zhvillohet më tej. Për këtë qëllim duhet të intensifikohet veprimet e nevojshme për të siguruar zbatimin e barazisë midis burrave dhe Gratë, në veçanti në lidhje për qasje në punësim, pagat, kushtet e punësimit, mbrojtjes sociale, arsimit, trajnimit profesional dhe zhvillimit të karrierës.

Por vetëm në gjysmën e dytë të viteve ‘90 që Bashkimi Evropian bëhet mjaft aktiv si në nivel ndërkombëtar ashtu edhe në nivel evropian në zbatimin e parimit të mos-diskriminimit. Në nivel ndërkombëtar, Bashkimi Evropian mori pjesë në Konferencën e Grave në Pekin¹⁵, dhe adopton parimin e ‘integritimit gjinor’ të cilën do ta trajtojmë më gjerësisht në vazhdimësi.

Në të njëjtën periudhë, Këshilli i Evropës miraton Rezolutën “për pjesëmarrjen e balancuar të grave dhe burrave në vendimmarrje”¹⁶; një vit më vonë, Komisioni miraton komunikimin “integroni mundësinë e shanseve të barabartë në mes të

Në Direktivën 2006/54/ KE edhe termat gjuhësore ndryshojnë pasi nuk përdoret më Punëtorët meshkuj dhe femra, por burra dhe gra; është e dukshme ndjeshmëria e Ligjvënësit të ri evropian i cili nuk dëshiron të shtrij parimin e trajtimit të barabartë vetëm për të punësuarit.

Shih Nani L.,, “Uguaglianza tra lavoratori e lavoratrici nel rapporto di lavoro, ne Div. dir., 1998, f. 390.

Shih Lanquentin M.T ne “De l’égalité des chances A propos de l’arrêt Kalanke, CJCE 17 octobre 1995, Droit social, 5/1996, p. 497.

Rekomandimi 84/635 i Këshillit të Ministrave për promovimin e aksioneve pozitive në favor të grave.

Shih Barbera M., “Dopo Amsterdam. I nuovi confini del diritto sociale comunitario”, Brescia, 2000

E miratuar në 1989.

E organizuar nga Kombet e Bashkuara dhe mbajtur në vitin 1995.

grave dhe burrave në të gjitha politikat e Komunitetit”¹⁷, merita e të cilit ishte se konsideronte të papërshtatshëm veprimin pozitiv si e vetmja masë e përshtatshme për të zbatuar politikën e realizimit të shanseve të barabarta duke deklaruar se: “Bashkimi Evropian përcakton parimin sipas të cilit barazia midis grave dhe burrave duhet të kihet parasysh vazhdimisht në të gjitha politikat dhe në të gjitha aktet e Komunitetit, që nga momenti i konceptimit të tyre në mënyrë publike.

Një meritë të padiskutueshme në përmirësimin e kushteve të punonjëseve gra në krahasim me kolegët e tyre burra ka edhe legjislatori spanjoll, me miratimin e ligjit nr. 07/03¹⁸, duke parashikuar një tërësi të drejtash dhe detyrimesh të personave fizikë dhe juridikë si publikë ashtu edhe privatë, me synim për të siguruar zbatueshmërinë e së drejtës për trajtim dhe shanse të barabarta¹⁹.

Një vlerë të veçantë kishte miratimi nga Spanja i një strategjie për integrimin gjinor, duke adoptuar udhëzimet e BE-së, me qëllim zbatimin praktik të parimit të trajtimit të barabartë në veçanti përmes eliminimit të diskriminimit kundër grave në çdo fushë të jetës, në mënyrë që të arrihet një shoqëri më demokratike, më të drejtë, dhe më shumë solidare²⁰.

Në të njëjtën periudhë filloi punimet dhe Konferenca Ndërqeveritare veçanërisht në tre fusha kryesore, domethënë: a) të bëjë më të kuptueshme për qytetarët e saj rëndësinë e Evropës së bashkuar; b) të sigurojë një funksionim sa me efikas të Bashkimi Evropian në mënyrë që të jetë sa me i përgatitur për zgjerimin e mëtejshëm; dhe c), ti njohë Bashkimit një kompetencë më të gjerë për të vepruar edhe në ambientin e jashtëm, për të cilin do të bashkohej edhe Grupi i Reflektimit²¹ me detyrën e promovimit e vlerave Evropiane. Këto vlera, si bazë e nevojshme për vetë ndërtimin demokratik të Evropës, kishin të nevojshme një shpalljes solemne, ashtu si dhe të drejtat themelore të cilat, në sajë të normave, ishin tashmë që prej 1995 pjesë e parimeve të përgjithshme të Bashkimit.

Në shpalljen solemne të vlerave evropiane, Grupi i Reflektimit mendonte se duhet të përfshihej edhe parimi i trajtimit të barabartë midis burrave dhe gratë, jo-diskriminim në bazë të racës, fesë, përkatësisë gjinore, moshës apo paaftësisë, dënimit e racizmit dhe ksenofobisë, si dhe për të parashikuar një procedurë ad hoc për zbatimin e tyre.

Në Qershor të 1996, me rastin e Këshillit Evropian të Firences, mori formë ideja e përfshirjes së një klauzolë të përgjithshme kundër diskriminimit; gjithashtu, në Këshillin Evropian të Amsterdimit, në Qershor të vitit 1997, projekti i Traktatit parashikonte parimin e mos diskriminimit.

Dallimi më i rëndësishëm qëndron në braktisjen e idesë së shpalljes solemne të ndalimit të diskriminimit, duke preferuar futjen drejtpërdrejt të një dispozite që përshkruan mekanizmin procedural të nevojshme për të luftuar këto forma të diskriminimit.

Risitë e paraqitura nga Traktati i Amsterdimit dalin nga teksti i ri i nenit 2, sipas së cilit Komuniteti ka për detyrë të nxisë barazinë midis burrave dhe grave, dhe nga pika 2 e nenit 3 sipas së cilës: “akti i Komunitetit ka për synim të eliminojë pabarazitë si dhe të promovojë barazinë midis burrave dhe grave”.

Disa studiues mendojnë se parimi i barazia reale bëhet jo vetëm një qëllim më vete i Komunitetit, por edhe një detyrim përshtatshmërie për veprimtarinë e institucioneve të Komunitetit në të gjitha nivelet e veprimit Evropian (pika 2 e nenit 3). Sipas këtyre studiuesve, parimi i barazisë “nuk përfundon në karakterin statik, tipik për ndalimin e diskriminimit, por është përforcuar edhe me një detyrim pozitiv ndaj autoriteteve publike të Komunitetit.

Pra për herë të parë, bëhet njohja e parimit të barazisë midis burrave dhe grave si një parim i përgjithshëm dhe frymëzuesi i veprimtarisë së Komunitetit, duke mos e kufizuar me aplikimin e saj vetëm në tregun e punës. Në Kreun XI të Traktatit del qartë roli i ri dhënë Komunitetit Evropian: nga një rol promovues dhe koordinues i veprimeve të shteteve anëtare në politikat sociale dhe edukim, në një rol mbështetës të aktiviteteve në nivel kombëtar, si dhe mundësinë e një ndërhyrje të drejtpërdrejtë.

Në këtë aspekt, ndryshimet e lidhura drejtpërsëdrejti me barazinë në paga janë tre: a) i pari ka të bëjë me futjen e të drejtave sociale përmes parashikimit të Kartës Sociale Evropiane të vitit 1961, si dhe Kartës së Komunitetit për të drejtat e punëtorëve të vitit 1989, në nenin 136; thirrje që tregon linjat bazë të aktiviteteve të ardhshme të Komunitetit dhe të vendeve anëtare²² ndonëse të drejtat sociale hyjnë, në rendin juridik të Komunitetit, si “interesa sociale reale të nivelit bazë dhe jo si pozita subjektive drejtpërdrejt të vlerësueshme.

Kështu, mund të thuhet se të drejtat sociale me Traktatin e Amsterdimit kanë arritur në një evoluim, nga funksione ndihmëse që gjatë procesit të integrimi evropiane kanë pasur gjithmonë respekt për lirinë ekonomik, në fitimin e një autonomie funksionale si pasqyrim i një rëndësie të re kushtetuese.

Ndryshimi i dytë është dhënë nga neni 137 që identifikon mjetet e nevojshme për të përmbushur objektivat e përgjithshme të përmendura në nenin 136, ku përmenden disa sektorë, duke përfshirë edhe atë të barazisë midis burrave dhe grave në tregun e punës dhe trajtimin në punë, në të cilat Komuniteti mund “mbështetje dhe të plotësojë” veprimet e shteteve anëtare, edhe përmes nxjerrjes së direktivave të Këshillit të Evropës në të cilat ajo mund të nxisin bashkëpunimin ndërmjet vendeve.

Rezoluta e Këshillit e 05/23/95. Në të njëjtin vit, Këshilli miraton Rezoluta për përdorimin e imazhit të burrave dhe grave në media e 10/05/95.

COM (96) 67 final.

Ky ligj ka si objekteve ish neni 1 për të bërë të mundshëm trajtimin e barabartë mes burrave dhe grave, përmes eliminimit të diskriminimit kundër grave në të gjitha sferat e jetës.

Shih Remiga V. La legge organica 3/07 “Per l’uguaglianza effettiva di donne e uomini: un decisivo passo in avanti della Spagna verso la parità di genere”, D.& L., 2007, f. 345

²¹ Grupi i Reflektimit themeluar me iniciativën e Këshillit Evropian të Korfuzit në Qershor të 1995 për të marrë pjesë në përgatitjet e Konferencës ndërqeveritare, përbëhej nga përfaqësues të Qeverive të shteteve anëtare.

Shih Direktiva 2006/54 / EC pika 4.

Së fundmi, neni 141 që kryesisht mbetet i pandryshuar, në pjesën më të madhe të tij, me përjashtim të futjes së pikës 3 që i jep Këshillit kompetencë për të marrë masa për zbatimin e parimit të shanseve të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave për punësim, duke përfshirë parimin e barbarisë në pagë²³.

Bie në sy fakti se aktet për të cilat Këshilli ishte i autorizuar të miratonte, sipas ish neni 141, ndryshojnë nga ato të përcaktuara nga neni 137: a) i pari i njej të drejtën Këshillit të miratojë “masa” të pa përcaktuara në mënyrë specifike; b) e dyta përmend vetëm direktivat.

Më tej, parimi i trajtimit të barabartë shtrihet në çdo aspekt të marrëdhënies së punës, përtej asaj të pagës, një fakt që gjen arsyetimin e saj në evolucionin moral të pasqyruar edhe në aktet e legjislacionit dytësor, të miratuar në bazë të nenit 253.

Pika 4 e nenit 141 më në fund deklaron përputhshmërinë e të ashtuquajturit aksion pozitiv me parimin e barazisë; shtetet anëtare janë të autorizuar të ndërmarrin masa për të dhënë privilegje të veçanta për gjininë më pak të përfaqësuar në një profesion të caktuar, ose për të kompensuar disavantazhet që hasen gjatë karrierave profesionale.

Neni 13 i jep gjithashtu Këshillit mundësinë e miratimit të akteve normativ të nevojshme për të luftuar diskriminimin e bazuar të gjinia, raca, prejardhja etnike, fesë, besimit personal dhe moshës. Por neni në vetvete nuk përmban konfirmimin formal të parimit të mos-diskriminimit, por i jep Këshillit të drejtën për të luftuar disa forma të veçanta të diskriminimit. Ofron, gjithashtu, një bazë juridike për miratimin e normave të Komunitetit, që përfshijnë mundësinë e trajtimit të privilegjuar në emër të realizimit të një barazie shoqërore reale.

Megjithatë, normativa e mos-diskriminimit duke pasur bazën ligjore në nenin 13 nuk do të mund të kishte rregulluar, për shembull, diskriminimin në lidhje me hyrjen në banesë ose në formimin profesional, pasi akomodimi në banesë nuk është një fushë kompetencë e Komunitetit, ndërsa e dyta është një fushë ku Komuniteti ka vetëm një funksion koordinimi.

Një tjetër element i diskutueshëm i ngjallur nga neni 13, përpara hyrjes në fuqi, është përmendja e adoptimit të “masave efikase” për të luftuar diskriminim, ku Këshilli i Evropës lihet i lirë të përdorë metodat që konsideron më të përshtatshme për arritjen e qëllimit pra ndërhyrja e Komuniteti mund të jetë vetëm përcaktimi i parimeve dhe kritereve të përgjithshme të një çështjeje duke i lënë dorë të lirë shteteve anëtare për integrimin e tyre nëpërmjet normave të brendshme.

Në qëllimet e ligjvënësive evropiane neni 13 duhet të përfaqësojë një mjet në gjendje për të mundësuar arritjen e objektivave kryesisht shoqërorë, mjet që do të çonte në jetësimin e idesë së shtetësisë evropiane. Në këtë këndvështrim do të kuptohet më qartë edhe leximi që i bëhet politikës sociale evropiane: një model i integritit ekonomik ose sipas një modeli të bazuar në shtetësinë sociale, evropiane.

Në modelin e parë, politika sociale evropiane është e lidhur ngushtë me integrimin ekonomik, është modeli i miratuar nga themeluesit e Komunitetit sipas të cilëve ngritja e tregut të përbashkët duhet të bazohet në ruajtjen e dallimeve të modeleve të ndryshme të shtetit social, dhe me zhvillimin e tregut të përbashkët do të përfitojë automatikisht një rritje e cilësisë së mirëqenies individuale. Dhe nëse do të lindte fenomeni social i dumping Traktati parashikonte mundësinë e ndërhyrjes si amortizues duke përdorur standardet më mbrojtëse në përdorim.

Në modelin e dytë Bashkimi Evropian shndërrohet në një garant ndërkombëtar i të drejtave themelore, përmes një kushtetutëzimi progresiv të të drejtave sociale me qëllim mbështetjen mbi baza të çelika të parimeve dhe vlerave të përbashkëta aktin e integritit pozitiv të sistemeve sociale të vendeve anëtare. Në këtë këndvështrim ndërthurja e të drejtave themelore sociale merr sot, një rëndësi të veçantë pasi kalohet nga një sistem i harmonizuar përmes mjeteve normative të detyrueshme në një sistem të harmonizuar përmes formave të koordinimit nëpërmjet soft law.

Udhërrëfyese i Bashkimit Evropian për vitet 2006 - 2010 parashikon një pavarësi ekonomike të barabartë për gratë dhe për burrat. Nëpërmjet këtyre fazave institucionet e Komunitetit kanë evoluar nga koncepti i pagesë së barabartë, deri në konceptin e shanseve të barabarta dhe jo më e lidhur ekskluzivisht me botën e punës, por që përfshin gjithashtu edhe sferën e qasje në punësim, trajnimin profesional, etj. Dhe në fakt, sipas Direktivës 2006/54/EC, shtetet anëtare janë të ftuara në bashkëpunim me partnerët socialë, për të trajtuar me këmbëngulje problemin e hendekut në pagë midis grave dhe burrave dhe ndarjen e mprehtë mes gjinive në tregun e punës, përmes riorganizimit të punës që lejojnë gratë dhe burrat për të pajtuar jetën familjare me jetën e punës.

3. Konkluzione

Përafrimi i legjislacionit tonë me përmbajtjen dhe frymën e konventave dhe rekomandimeve ndërkombëtare, përfaqëson një oportunitet të rëndësishëm për ecjen përpara në rrugën drejt anëtarësimit të plote në Bashkimin Evropian. Sipas nenit 5 të Kushtetutës sonë “Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të”. Një ndër to, Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP-ILO), deri tani ka miratuar shumë konventa dhe rekomandime që mbulojnë çështjet e punës, shumica e të cilave zbatohen në mënyrë të barabartë si për gratë ashtu edhe për burrat. ONP kujdeset për hartimin dhe respektimin e legjislacionit të punës në vendet anëtare. Kështu, gruaja gëzon të njëjtat të drejta si dhe burri në fusha të ndryshme, nën mbikëqyrjen e ONP-s, si të drejtat themelore humane, punësimi, trajtimi në punë, kushtet në punë, mos diskriminimi etj. ONP ka krijuar gjithashtu një sërë standardesh në lidhje me punën e grave, të cilat janë ratifikuar nga vendi ynë ku me kryesoret janë Ligji 8086, dt. 13.03.1996 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, Konventa nr. 111 “Për diskriminimin në punë dhe profesion; Ligji 8829, dt. 05.11.2001 “Për ratifikimin e Konventës nr. 183 “Mbrojtja e amësisë” të ONP; Ligji 8787, dt. 07.05.2001 Për ratifikimin e Konventës nr. 95

Shih Raport i Komitetit Simitis.

“Mbrojtja e pagave, 1949” të ONP; Ligji 9197, dt. 26.02.2004 “Për ratifikimin e Konventës nr. 171 “Mbi punën e natës, 1990” të ONP etj.

Një kontribut mjaft të rëndësishëm ka dhënë edhe e drejta evropiane, e cila u analizua gjerësisht më sipër, kur vendi ynë ka nënshkruar MSA-në dhe së fundmi ka marrë edhe statusin e ‘vendit kandidat’ për në BE. Normativa komunitare përbënë një burim të drejtpërdrejtë në rendin tonë juridik. Ne këtë aspekt, vlen të theksohet kontributi i Kartës së të Drejtave Themelore të BE. Kreu III i Kartës i është dedikuar barazisë së punonjësve, ndër to edhe ajo ndërmjet burrit dhe gruas.

Duke ju referuar neneve 5 dhe 122 të Kushtetutës sonë, Kodi i Punës parashikon se në majën e hierarkisë së normave të aplikueshme në vendin tonë, në radhë të parë vjen Kushtetuta dhe më pas konventat ndërkombëtare të ratifikuara si dhe traktatet në të cilat vendi ynë është palë. Kjo do të thotë në këtë stad evoluimi dhe tranzicioni që po përjeton shoqëria jonë drejt anëtarësimit të plotë në strukturat e Bashkimit Evropian, zona ndarëse ndërmjet legjislacionit vendas në fuqi dhe atij të huaj të detyrueshëm për vendin tonë, sa vjen dhe bëhet më e padukshme. Shohim se një pjesë e sovranitetit legjislativ të vendit ‘transferohet’ gradualisht, me bekimin e normave të Kushtetutës së R.SH., të institucioneve ndërkombëtare dhe veçanërisht tek ato të BE-së. Në këtë kuptim të gjitha normat e brendshme ekzistuese do të interpretohen dhe përshtaten me frymën e normave të institucioneve ndërkombëtare të ratifikuara, ndërkohë që norma të tjera të huaja do të adoptohen dhe do bëhen drejtpërdrejtë pjesë e rendit tonë juridik.

Bibliografia

- Barbera M.- Dopo Amsterdam. 2000. I nuovi confini del diritto sociale comunitario, Promodis, Brescia.
- Directive 76/207/CEE du Conseil, du 9 février 1976.
- Directive 79/7/CEE du Conseil, du 19 décembre 1978.
- Directive 86/378/CEE du Conseil du 24 juillet 1986.
- Directive 86/613/CEE du Conseil du 11 décembre 1986.
- Directive 2006/54/CE du Parlement Européen et du Conseil du 5 juillet 2006.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998, Tiranë.
- Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, 2012, Tiranë, Qendra e Publikimeve Zyrtare.
- Lanquentin M.T.- De l'égalité des chances CJCE 17 octobre 1995, Droit social, 5/ 1996. A propos de l'arrêt Kalanke, p. 494 ss.
- Martin D.- Discriminations, 2008, entraves et raions imperieuses dans le Traité CE: trois concepts et quête d'identité, in Cahiers de droit européen, p. 263.
- Merger Treaty - Brussels Treaty, 1967, Official Journal of the European Communities.
- Nani L. - 78, 1998, 2. Uguaglianza tra lavoratori e lavoratrici nel rapporto di lavoro, in Dir. Lav. Rel. Ind.
- Remiga V.- D.&L., 2007, 2, La legge organica 3/ 07 per l'uguaglianza effettiva di donne e uomini: un decisivo passo in avanti della Spagna verso la parità di genere, p. 345 ss.
- Strazzari D.- 2008 Discriminazione razziale e diritto un'indagine comparata per un modello europeo del antidiscriminazione, Cedam editore.
- Singel European Act, 1987 Official Journal of the European Communities.
- Treaty on European Union - Maastricht Treaty 1992, Official Journal of the European Communities.
- Treaty of Amsterdam, 1999. Official Journal of the European Communities.
- Treaties of Rome – 1957 EEC and EURATOM treaties, Official Journal of the European Communities.

AFATET PRODECURALE TË GJYKIMIT KUSHTETUESE NË KONTROLLIN ABSTRAKT NDAJ AKTEVE NORMATIVE ME FUQINË E LIGJIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

GERTI SHELLA

Kandidat PHD, UET

ABSTRAKT

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka juridiksion të veçantë për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjerë normative. Ajo ka kompetencë të vendosë mbi papajtueshmëria e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare (neni 131, par.3). Në këtë kategori përfshihen (ex vi termini) edhe Aktet Normative me Fuqinë e Ligjit të Këshillit të Ministrave (*më poshtë referuar shkurt :ANFL*). Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve.

Trajtesa synon të vlerësojë efektshmërinë e vendimmarrjes¹ së Gjykatës Kushtetuese kur ajo ushtron kontrollin kushtetues ndaj ANFL. Sipas Oxford Dictionaries, efektshmëri do të thotë *suksesi në prodhimin apo gjenerimin e një rezultati të synuar*². Meqenëse Gjykata Kushtetuese, synim parësor ka të garantojë respektimin e Kushtetutës³, një vendimmarrje e efektshme prej saj do të ishte pikërisht ajo që prodhon apo gjeneron si rezultat parësor pikërisht respektimin e Kushtetutës; e nëse kjo nuk garantohet, pavarësisht cilësisë së vendimmarrjes apo jurisprudencës së GJK, është logjike të pohohet se efektshmëria në këtë rast do të ishte “e diskutueshme”.

Analiza teorike aplikohet ndaj marrëdhënies që lind nga ndërveprimi i dy shpejtësive të ndryshme në terma të efekteve juridike që prodhon akti. Rezultantja e këtyre dy shpejtësive (vektorëve) indikon efektshmërinë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, madje e determinon atë. Kusht parësor që vendimi i GJK të ketë efektshmëri⁴ kur objekt shqyrtimi prej saj janë ANFL është vetë KOHA; cilësia e vendimit në këtë rast jo domosdoshmërisht përcakton efektshmërinë e tij. Kjo është një nga tezat që kjo trajtesë merr përsipër të argumentojë.

Fjalët kyçe: *Gjykata Kushtetuese, akt normative me fuqinë e ligjit ANFL, Kontrolli kushtetues, hyrja në fuqi e aktit, kontrolli ex ante dhe ex post.*

Arsyetimi dhe urdherimi I vendimit...keto janë të pandara (shih materialet e hapura)....

(<http://www.oxforddictionaries.com/definition/english/effective>)

neni 124/1 i Kushtetutës

Sipas Oxford Dictionaries, “efektshmëria” definohet si *suksesi në prodhimin apo gjenerimin e një rezultati të synuar* ([http://www.](http://www.oxforddictionaries.com/definition/english/effective)

[oxforddictionaries.com/definition/english/effective](http://www.oxforddictionaries.com/definition/english/effective))

Hyrje

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj (neni 124/1 i Kushtetutës). Ajo ka juridiksion të veçantë për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjerë normative. Kushtetuta liston në mënyrë shteruese llojet e çështjeve mbi të cilat kjo Gjykata ka kompetencë të vendosë. Ndër të është dhe papajtueshmëria e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare (neni 131, par.3).

Në këtë kategori përfshihen (ex vi termini) edhe Aktet Normative me Fuqinë e Ligjit të Këshillit të Ministrave (*më poshtë referuar shkurt: ANFL*). Sipas nenit 101 të Kushtetutës, *Këshilli i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mbledhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve.*

Në një rast të tillë, Pushteti Ekzekutiv vesh atributet e Pushtetit Legjislativ. Edhe për aq sa kjo është një kompetencë me natyrë përjashtimore, debati lidhur me ushtrimin e këtij atributi nga Ekzekutivi vijon të mbetet i hapur sot e kësaj dite, jo vetëm në Shqipëri, por edhe më gjerë. Sigurisht, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka krijuar një jurisprudencë të sajën mbi këtë tematikë, e cila do të analizohet dhe referohet më poshtë sipas rastit. Megjithatë, debati nëse duhet apo nuk duhet që Pushteti Ekzekutiv të ketëtribute të Legjislativit nuk është objekti parësor i këtij punimi.

Trajtesa në fakt synon të vlerësojë efektshmërinë e vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese kur ajo ushtron kontrollin kushtetues ndaj ANFL. Sipas Oxford Dictionaries, efektshmëri do të thotë *suksesi në prodhimin apo gjenerimin e një rezultati të synuar*⁷. Meqenëse Gjykata Kushtetuese, synim parësor ka të garantojë respektimin e Kushtetutës, një vendimmarrje e efektshme prej saj do të ishte pikërisht ajo që prodhon apo gjeneron si rezultat parësor pikërisht respektimin e Kushtetutës; e nëse kjo nuk garantohet, pavarësisht cilësisë së vendimmarrjes apo jurisprudencës së GJK, është logjike të pohohet se efektshmëria në këtë rast do të ishte “e diskutueshme”.

objekt i analizës së kësaj trajtese është marrëdhënia në kohë midis efekteve që prodhon ANFL nga njëra anë dhe efekteve që prodhon vendimi i GJK që e shfuqizon atë, nga ana tjetër. Dihet se, ANFL për shkak të natyrës së tyre, fillojnë të prodhojnë efektet e synuara nga Këshilli i Ministrave që me miratimin e aktit⁹, pra menjëherë. Ndërkohë, kontrolli kushtetues ndaj akteve normative (ku futen edhe ANFL), ushtrohet ex-post. Thënë ndryshe, që GJK të këtë objekt shqyrtimi kushtetueshmërinë e një akti normativ, duhet që fillimisht ky akt të ekzistojë juridikisht. Edhe në rastin kur kontrolli kushtetues ushtrohet ex-ante, si në rastin e marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit nga Kuvendi, sërish Gjykata Kushtetuese merr në shqyrtim një projekt marrëveshje, e cila është po ashtu një akt juridik mirëfilli (në shumicën e rasteve është një VKM I njëjtë si ato që i nisin procesin e propozimit të projektligjeve për miratim në Kuvend). Gjykata Kushtetuese, tek e fundit, ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton (neni 132/1 i Kushtetutës).

Është e evidente se, në këto kushte, analiza aplikohet ndaj një marrëdhënie që lind nga ndërveprimi i dy shpejtësive të ndryshme në terma të efekteve juridike që prodhon aktit. Rezultantja e këtyre dy shpejtësive (vektorëve) indikon efektshmërinë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, madje e determinon atë. Kusht parësor që vendimi i GJK të ketë efektshmëri¹⁰ kur objekt shqyrtimi prej saj janë ANFL është vetë KOHA; cilësia e vendimit në këtë rast jo domosdoshmërisht përcakton efektshmërinë e tij. Kjo është një nga tezat që kjo trajtesë merr përsipër të argumentojë.

Kur flitet për hyrjen në fuqi të një vendimi të GJK, sidomos në rastet kur kjo e fundit shqyrton kushtetutshmërinë e një ANFL, ka një seri çështjes që meritojnë vëmendje dhe kujdes. Këto çështje ngrejne një seri pyetjesh që kanë të bëjnë me doktrinën por edhe me vetë përcaktimet normative që rregullojnë mënyrën e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese.

Së pari, nisur nga vetë natyra e ANFL, i cili i fillon efektet menjëherë, a ka vend të pretendohet edhe nga GJK e njëjta urgjencë në ushtrimin e kontrollit kushtetues ndaj një akti të tillë? A ka diçka më shumë që mund të pretendohet edhe sa i takon mënyrës së hyrjes në fuqi të një vendimi të GJK që shfuqizon një ANFL?

Së dyti, a janë të efektshme vendimet e GJK¹¹ jashtë një konteksti të përcaktuar kohor dhe specifikisht kur ajo ushtron kontrollin kushtetues ndaj një ANFL? A ka tek e fundit kuptim fraza standard: “*GJK vendosi shfuqizimin si të papajtueshmëm me Kushtetutën të ANFL...*”, nëse, siç ndodh rëndom, ANFL, për nga vetë natyra e tij, mund t’i ketë ezauruar të gjitha efektet e synuara brenda kohës në të cilën shtrihet apo ekziston juridikisht (max: 45 ditë)?

Së treti, nëse një ANFL, brenda harkut kohor prej 45 ditësh adoptohet (ratifikohet) nga Kuvendi si një ligj normal, por, në një kohë të mëvonshme hidhet poshtë nga Gjykata Kushtetuese, si vlerësohet kushtetutshmëria e vetë ligjit dhe si prapësohen efektet që mund të kenë prodhuar respektivisht ANFL dhe ligji adoptues?

Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor (neni 7 i Kushtetutës). Këshilli i Ministrave ushtron çdo funksion shtetëror, i cili nuk u është dhënë organeve të pushteteve të tjera shtetërore ose të qeverisjes vendore (Neni 95/2 I Kushtetutës).

Arsyetimi dhe urdherimi I vendimit... keto janë të pandara (shih materialet e hapura)....

(<http://www.oxforddictionaries.com/definition/english/effective>)

neni 124/1 i Kushtetutës

Shih interpretimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.....

Sipas Oxford Dictionaries, “efektshmëria” definohet si *suksesi në prodhimin apo gjenerimin e një rezultati të synuar* (<http://ëëë.oxforddictionaries.com/definition/english/effective>)

Kur objekt shqyrtimi janë aktete normative me fuqinë e ligjit që nxjerr KM

Rasti në analizë

Vendimi i GJK nr.5/2014 ofron një terren mjaft interesant për nisjen e një analize që synon t'i japë përgjigjet pyetjeve të mësipërme. Në Tetor 2013, GJK mori në shqyrtim kërkesën e një grupi prej 36 deputetësh (grupi parlamentar i PD), me objekt: *Shfuqizim, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të aktit normative me fuqinë e ligjit nr.5, datë 30.09.2013 "Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil"*;

Gjykata Kushtetuese, me shumicë votash, V E N D O S I: 1) Pranimin e kërkesës dhe 2) Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të ANFL nr.5, datë 30.09.2013 dhe të ligjit të Kuvendit nr.161/2013 "Për miratimin e aktit normativ nr.5, datë 30.09.2013". Vendimi mban datën 05.02.2014

Që në fillim të Janarit 2014, mediat, në mëse një rast, botuan projekt-vendimin e GJK¹³, ku tashmë ishin të përvijuara qartë linjat e arsytimit të shumicës (5 gjyqtarë). Sipas këtyre mediave, vendimi (në kuptimin e dispozitivit) duhet të jetë arritur nga fillimi i Dhjetorit 2013, kohë në të cilën ANFL nr. 5 i KM ishte kthyer në ligj të zakonshëm nga Kuvendi...Për më tepër, ANFL nr.5 filloi prodhimin e efekteve të synuara që me nxjerrjes së tij, konkretisht në 30 Shtator 2013 (Ligji 152/2013 që ai "targetonte" ishte paracaktuar të hynte në fuqi në dt. 1 Tetor 2013).

Vendimi i GJK nr.5/2014 u shpall i arsytuar përmes leximit në seancë (sallë), konform përcaktimit ligjor¹⁴. Pavarësisht se GJK e shpalli të arsytuar vendimin në fjalë solemnisht dhe në prani të palëve, dhe pavarësisht se ajo vetë e publikoi atë menjëherë pas shpalljes në faqen e saj zyrtare¹⁵, vendimi duhej të priste akoma shumë ditë për të hyrë në fuqi. Qendra e Botimeve Zyrtare e botoi vendimin në fjalë plot 21 ditë nga shpallja e tij. Vendimi u botua në Fletoren Zyrtare nr.18, të datës 26 Shkurt 2014. Nga një analizë e posaçme e realizuar për qëllimin e këtij studimi, kjo përbën edhe kohën më maksimale të botimit të një vendimi të GJK në Fletore Zyrtare krahasuar me të gjitha vendimet e tjera për vitin 2013¹⁶. Që nga momenti i shpalljes së vendimit e deri në botimin e tij, QBZ nxori në qarkullim 9 Fletore Zyrtare të tjera, një pjesë e së cilave procesuan për botim akte me datë lëshimi më të vonë se ajo e vendimit të GJK nr.5/2014.

Teorikisht dhe praktikisht, në këtë teatër institucional, fijet për hapjen e siparit (nxjerrja e aktit normativ), edhe mbylljen e tij (hyrja në fuqi e vendimit të GJK përmes botimit në FZ) lëvizën prej duarve të Qeverisë. Vetë Gjykata Kushtetuese nuk është aq shumë një aktor institucional se sa një spektator, kur luhet "akti i fundit" i këtij procesi legjislativ me dy faza, njëra pozitive dhe tjetra negative (pra nxjerrja e aktit nga KM dhe shfuqizimi i tij më pas nga GJK).

Për më tepër, në kohën që ky vendimi i GJK hyri në fuqi më dt. 26 shkurt 2014, kishin mbetur diçka më shumë se 1 muaj (34 ditë ekzaktësisht) që efektet e synuar nga ANFL nr. 5 dhe ligji miratues 161/2013 të ezauroheshin vetvetiu. Në fund të fundit, ANFL nr.5 u nxor për shtyrjen me 6 muaj të hyrjes në fuqi të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil". Në dispozitat kalimtare të ligjit në fjalë, ishte parashikuar që ai të hynte në fuqi më 1 Tetor 2013, ndërkohë që, me një përllogaritje të thjeshtë, shtyrja me 6 muaj e këtij afati shënjon datën 1 Prill 2014.

Rasti në fjalë pra, ofron një terren mjaft interesant për nisjen e një analize që synon t'i përgjigjet pyetjeve që u afishuan më sipër. Analiza që vijon më poshtë është sa hipotetike aq edhe praktike, duke supozuar në secilin rast vetëm opsione të mundshme të ndërveprimit si institucional ashtu dhe juridik mes vetë akteve, respektivisht një ANFL dhe një vendimi përfundimtar të GJK që e shfuqizon atë.

Mbi hyrjen në fuqi dhe shtrirja e efekteve të ANFL

Fuqia juridike është element i pandashëm i përmbajtjes së normës. Sipas interpretimit të Gjykatës Kushtetuese, në vendimin e saj nr. 24, datë 10.11.2006 (V – 24/06), një ANFL është ligj në kuptimin material të termit, por jo në kuptimin formal të tij. Fuqia juridike e ANFL është e barabartë me fuqinë e ligjit që nga momenti i nxjerrjes së tij (ANFL¹⁷).

Sipas Kushtetutës (neni 117/1) Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare. Sa i takon hyrjes në fuqi të një ANFL, vetë Kushtetuta nuk bën parashikime të posaçme, çka implikon se përcaktimet e nenit 117 zbatohen njësoj edhe për ANFL.

Megjithatë, sipas interpretimit që GJK¹⁸ ka bërë normës kushtetuese, nenit 101 dhe 117 në rastin konkret, hyrja në fuqi e ANFL dallon nga hyrja në fuqi e ligjit. ANFL duhet ta disponojnë fuqinë juridike që nga krijimi i tyre, me qëllim që të ekzistojë mundësia për ta humbur atë po nga fillimi, kur nuk miratohen prej Kuvendit, si dhe kur kalon afati 45 ditor pa u marrë në shqyrtim prej tij. Sipas GJK, hyrja e tyre menjëherë në fuqi është rrjedhojë logjike e kushteve të nevojës dhe urgjencës

Objekti i plotë: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 30.09.2013 Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 Për nëpunësin civil; Shfuqizimi i ligjit nr.161/2013 Për miratimin e aktit normativ nr.5, datë 30.09.2013 Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 Për nëpunësin civil; Pezullimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese

Shih gazeta "MAPO", kryeartikulli i nr 1102, e marte, 7 janr 2014 nga Fejzi Braushi; shih edhe Revista Java, nr...dt...

Neni 72 "Marrja e vendimit dhe shpallja e tij", L I G J Nr.8577, dt. 10.2.2000 PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E

GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Shih ketu: http://ëëë.gjk.gov.al/ëëë/Vendime_perfundimtare_100_1.php

Gjatë vitit 2013, GJK ka dërgua për botim në Fletore zyrtare 55 vendime përfundimtare. Të gjitha këto vendime nuk e kalojnë afatin 15 ditor nga shpallja e tyre deri në dotim, me përjashtim të vendimit nr 48, i cili është botuar 19 ditë pas shpalljes (FZ 189, dt 4.12.2013)

Shenim i autorit (G.Sh)

Po aty, Vendimi nr. 24, datë 10.11.2006 (V – 24/06)

në të cilat një ANFL nxirret. Në këtë kontekst, GJK ka arsyetuar se bërja publike e këtyre akteve nuk ka si domosdoshmëri botimin në Fletoren Zyrtare (vendim nr. 24, datë 10.11.2006).

Ndryshe nga GJK, ligjvënësi ka patur një tjetër qasje në raport me kohën në të cilën duhet realizuar botimi në Fletore Zyrtare i një ANFL, dhe sigurisht me kohën në të cilin duhet të fillojnë të ecin afatet. Në ligjin organik nr. 9000, dt. 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e KM", neni 29, para. 1 përcakton shprehimisht se "Aktet normative me fuqinë e ligjit të KM botohen menjëherë në Fletore Zyrtare". Ligjvënësi megjithatë, nuk ka bërë parashikime të mëtejshme të karakterit kumulativ, që do të kushtëzonin fuqinë juridike të ANFL me botimin e tij në Fletore Zyrtare.¹⁹

Lidhur me fazën II, pra procesin legjislativ në Kuvend nëpër të cilin kalon më pas ANFL, Gjykata Kushtetuese ka interpretuar se Kuvendi disponon targa të plota për të zgjedhur një nga tre alternativat: *të marrë në shqyrtim dhe ta miratojë aktin e nxjerrë nga Këshilli i Ministrave; ta marrë në shqyrtim dhe të mos e miratojë atë; të heshtë, derisa të plotësohet afati 45 ditor, që dispozita kushtetuese i ka lënë në dispozicion për t'u shprehur lidhur me aktin.*

Nga parashtrimet del qartë se Gjykata Kushtetuese, përmes interpretimeve të saj, i ka lejuar Qeverisë që ANFL t'i futë në fuqi menjëherë dhe të mund t'i botojë ato në Fletore Zyrtare në një kohë të dytë nga hyrja në fuqi. Ky interpretim i GJK, në vlerësimin e autorit të kësaj trajtese, mund dhe duhet të ri-konsiderohet: Së pari, nisur nga dinamika e krijuar pas adoptimit të një kuadri ligjor bashkëkohor për botimet zyrtare, ku shpejtësia e publikimit të aktit është e garantuar përmes botimit elektronik të Fletores Zyrtare. Së dyti, çka është dhe më e rëndësishme, nisur edhe nga rrethana statike se, në nenin 117 të saj Kushtetuta thotë prerë se: "Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare". Në fund të fundit GJK ka mision garantimin e Kushtetutës, e cila në këtë rast duket se nuk lë shumë shteg për interpretim. Vetë precedenti i botimit të menjëhershëm të ANFL nr.5 në Fletore Zyrtare 159, vetëm një apo dy orë pas miratimit të aktit nga KM, është prova e gjallë që GJK ka bërë një arsyetim të diskutueshëm të cilin praktika e verifikueshme por dhe përmirësimet ligjore në legjislationin e botimeve zyrtare (që lejojnë botimin elektronik të aktit) nuk e mbështesin aspak.

Hyrja në fuqi e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe shtrirja e efekteve të tyre

Ndryshe nga ANFL, vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare (neni 132/2 i Kushtetutës). Edhe pse përcaktimi kushtetues është i prerë në këtë rast, në ligjin organik të GJK²⁰, ligjvënësi ka parashikuar rastin përjashtimor, kur një vendim përfundimtar i GJK lejohet të hyjë në fuqi menjëherë. Konkretisht, "kur vendimi ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit, Gjykata mund të vendosë që ai të hyjë në fuqi me shpalljen e tij" (neni 26, paragrafi 1, ligji 8577, dt. 10.2.2000)

Ligjvënësi megjithatë nuk i ka parashikuar apo caktuar një afat brenda të cilit GJK duhet të dërgojë për botim në Fletore Zyrtare vendimet e saj përfundimtare, me qëllim që këto të marrin fuqi juridike. Ligji organik i GJK përcakton vetëm se: "Organi që boton Fletoren Zyrtare detyrohet të bëjë botimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, jo më vonë se 15 ditë nga ardhja për botim e tyre pranë atij organi" (neni 26, para. 2). Siç kuptohet, kjo dispozitë kujdeset të caktojë afat për QBZ, por jo më së pari një afat për vetë GJK.

Kjo specifikë, pra që edhe dërguesit i duhet caktuar afat, është mbajtur mirë parasysh nga ligjvënësi në rastin e Gjykatës së Lartë. Në ligjin organik të kësaj të fundit, përcaktohet shprehimisht se "Vendimet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare"²¹.

Duhet mbajtur parasysh se hyrja në fuqi e një akti përmes botimit në Fletore Zyrtare implikon një marrëdhënie "dërgues-marrës", në rastin konkret të GJK dhe QBZ. Kjo e fundit është një institucion qendror varësie²² dhe funksionon me ligj të veçantë (nr. 78/2014²³). Afatet e "marrësit, pra afatet brenda të cilave QBZ duhet të botojë aktet e institucionit "dërgues", janë të rregulluara qartësisht në ligjin e saj. Ligjvënësi ka zgjedhur gjithashtu të rregullojë përmes këtij ligji të thjeshtë²⁴ edhe detyrimet mbi afatet e dërgimit të akteve të botueshme pranë QBZ nga institucionet "dërguese". Këto të fundit, në shumicën e tyre janë institucione qendrore kushtetuese, ligjet organikë të të cilave miratohen me shumicë të cilësuar, konform përcaktimeve të nenit 81/2 të Kushtetutës .

Konkretisht, përsa i takon VKM me karakter normativ (akt nënligjor), neni 29 "Hyrja në fuqi e akteve", ligji 9000/2003, bën këtë përcaktim: "Vendimet e Këshillit të Ministrave marrin fuqi juridike pasbotimit në Fletoren Zyrtare. Për vendimet me karakter normativ mund të caktohet si datë hyrjeje në fuqi një datë tjetër nga ajo e botimit në Fletoren Zyrtare, ndërsa vendimet me karakter individual hyjnë në fuqi menjëherë, por botohen në Fletoren Zyrtare."

L I G J Nr.8577, datë 10.2.2000 PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 19 "Vendimet dhe botimi i tyre", Ligji L I G J Nr. 8588, datë 15.3.2000 (version i konsoliduar) "Per organizimin dhe funksionimin e GJL"

Qendra e Botimeve Zyrtare është person juridik publik, me seli në Tiranë, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë (neni 4 "Statusi i Qendrës së Botimeve Zyrtare", ligji Ligji nr.78/2014.

Ligji nr.78/2014 datë 10.7.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare" është një ligj i miratuar me shumicë të thjeshtë. Ai ka shfuqizuar ligjin nr. 96/2012 "Për Qendrën e Botimeve Zyrtare". Ky i fundit, ka shfuqizuar më parë ligjin nr.8502, datë 30.6.1999 "Për Krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare"

²⁴ Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave. Pra, ligji në fjalë është miratuar me shumicën e thjeshtë, kur realizohet pjesëmarrja në seancë plenare e më shumë se gjysmës së deputetëve.

Për t'u kthyer tek afatet e botimit, sipas përcaktimeve të ligjit nenit 8 të ligjit 78/2014, "*Vendimet e Gjykatës Kushtetuese dërgohen për botim brenda 5 ditëve nga data e nënshkrimit të tyre*". Pas ezaurimit të këtij afati të "dërguesit", fillojnë dhe ecin afatet "e marrësit". Konkretisht, ligji 78/2014 i vendos QBZ në dispozicion të saj 10 ditë nga data e marrjes së aktit të botueshëm për ta procesuar atë dhe për ta botuar në Fletore Zyrtare (neni 10/1, ligji 78/2014). Në total, konform legjislacionit më të ri në fushën e botimeve zyrtare, koha maksimale nga nënshkrimi i një akti të botueshëm e deri në botimin e tij në Fletore zyrtare është 15 ditë.

Është e qartë në këtë pikë se ligji organik për Gjykatën Kushtetuese minimalisht mund të përmirësohet të paktën në dy drejtime: se pari, në unifikimin e afateve të botimit me standardin më të ri ligjor të vendosur në RSH; së dyti, për të parashikuar në dispozitat e veta afate të cilave "dërguesi" duhet t'u përmbahet për dërgimin e vendimit përfundimtar për botim në Fletore Zyrtare.

Kjo edhe për arsytet e thjeshtë se një ligj i thjeshtë nuk mund të imponojë afate ndaj një ligji organik që miratohet me 3/5, në respekt të parimit të hierarkisë së akteve. Thënë ndryshe, GJK në secilin rast mund të zgjidhte "të injoronte" detyrimin që i ngarkohen asaj një ligj i cili, përveçse është inferior në terma hierarkisë normative, nuk ka tek e fundit objekt rregullimin e funksionimit të GJK, por të një institucioni qeveritar varësie (në këtë rast QBZ).

Dy shpejtësi vektoriale të kithëta

Do ishte logjike dhe e dobishme të pretendohet që, kur GJK shqyrton kushtetutshmërinë e ANFL, vendimet e saj të hyjnë në fuqi me shpalljen e tyre, njësoj sikurse ligji i saj (jo kushtetuta) ia lejon për vendime përfundimtare që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit. Në një rast të tillë, GJK "paradoksalisht, por me të drejtë" e kapërcen kufirin që i cakton asaj neni 132 i Kushtetutës, i cili parashikon se: "*Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare*".

Për atë që kjo legjitimohet, duhet pohuar se mbrojtja e të drejtave kushtetuese të individit është në shumicën e rasteve *time-sensitive*, nganjëherë në masë të tillë sa çdo vonesë që lidhet me praktikën e përgatitjes dhe nxjerrjes për botim të një numri standard të fletore zyrtare mund të thëllonte objektivisht shkeljen e këtyre të drejtave. Për analogji, efektet e prodhuara nga një akt normativ mund të jenë edhe më tepër *time-sensitive*, madje me impakt jo thjesht mbi një individ, por mbi grupe të tëra shoqërore, të cilët, po njësoj kanë të drejtë të gëzojnë garancitë kushtetuese dhe ligjore që ju ofrohen nga regjimi i brendshëm juridik. E drejta për punë, jetesë, dinjitet, trajtim jo-diskriminues mbi baza të besimit e përkatësisë politike etj, me të cilat akti normativ nr.5, datë 30.09.2013 "*Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil"*" mendohet se ka rezonuar negativisht, janë të drejta dhe garanci kushtetuese gjithashtu.

Po le t'i leme mënjatë për një çast afatet e hyrjes në fuqi të vendimeve të GJK dhe të lexojmë nenin 72 të ligjit organik të saj, i cili në pikën 4 dhe 7 të tij përcakton: (4.) *Për shpalljen e vendimit njoftohen pjesëmarrësit në proces. Mungesa e tyre nuk pengon shpalljen e tij;* (7.) *Vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi detyruese të përgjithshme dhe është përfundimtar.*

Kur shoh këto përcaktime, arsyeja e shëndoshë sugjeron një pyetje: përse duhet që, pasi i është shpallur dhe lexuar në sy palëve vendimi i gjykatës, ato të presin që ai të hyjë në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare?!

Kjo pyetje mbart edhe një koherencë të dytë logjike, çka e kthen praktikisht atë në një pyetje retorike: Një vendim gjykate është thelbësisht një akt me natyrë individuale. Subjektet që akti adreson janë të identifikueshme. Edhe për këtë arsye, ligjvënësi ka parashikuar në ligj se "*Për shpalljen e vendimit njoftohen pjesëmarrësit në proces*". *Është e qartë se pjesëmarrësit janë palët e legjitimuara, të cilat investojnë në këtë rast Gjykatën Kushtetuese për të bërë interpretimin abstrakt të normës juridike. Mjafton vetëm konstatimi i kësaj rrethanë për ta pretenduar ndarjen e botimit të vendimeve të GJK nga hyrja në fuqi e tyre.*

Fletorja Zyrtare është padyshim dokumenti zyrtar ku duhet të botohet jurisprudenca e GJK, pasi vetëm kështu ajo njihet referohet zyrtarisht si e tillë, por hyrja në fuqi e vendimit mund të nisë me njoftimin e palëve të legjitimuara. Vetë GJK e ka njohur si legjitime dhe lejuar këtë praktikë, madje për hyrjen në fuqi të vetë ANFL, që janë akte me fuqi detyruese të përgjithshme (vendimi 24/2006).

Për aktet me natyrë individuale kjo është një procedurë e standardizuar, të paktën në terma të diskrecionit që ligjvënësi i ka njohur në përgjithësi institucionit që nxjerr akte. Si shembull konkret mund të merret ligji 9000, dt.3/1/2003, "*Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave*". Lidhur me futjen në fuqi të akteve të KM, neni 29/2, fjalía e fundit, përcakton se: "*vendimet (VKM) me karakter individual hyjnë në fuqi menjëherë, por botohen në Fletoren Zyrtare.*"

Botimi në Fletore Zyrtare në këtë rast realizohet pra në një kohë të dytë, me synim që palë të treta, jo-lehtësisht-të-identifikueshme, të marrin njoftim mbi aktin e nxjerrë, që të përftojë dhe/apo mos-dëmtohen nga efektet që sjell akti nënligjor. E njëjta logjikë aplikohet dhe funksionon edhe për vendimet unifikuese të Gjykatës së Larët, ku ligji organik 8588/2000²⁵ parashikon botimin e tyre në Fletore Zyrtare menjëherë pas shpalljes. Në këtë rast botimi në Fletore Zyrtare nuk ka vlerë për palët në proces, por për marrjen zyrtarisht dijeni mbi këtë vendim nga trupa gjyqësore e gjykatave më të ulëta, të cilat duhet të njehsojnë tashmë praktikën e shqyrtimit gjyqësor konform udhëzimeve të vendimit unifikues për çështje të njëjta apo të ngjashme. Imagjioni për një moment sikur një vendim unifikues penal, i cili urdhëron ndër të përfundimin e kohës së burgut të njëjës prej palëve në gjykim, të mos hynte në fuqi pa u botuar më parë në Fletore Zyrtare! Rëndësi parësore në këtë rast ka zbatimi i urdhëresave të vendimit në kohë sa më të shkurtër (që askush të mos vuajë në burg asnjë minutë më shumë sa kohë që nuk ka tashmë një vendim gjyqësor që do kufizonte lirinë e tij) dhe më pas edhe njohja e jurisprudencës

Neni 19/3, ligji 8599, dt. 15.03.2000 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës së Larët në RSH*", i ndryshuar

nga të gjithë të interesuarit e tjerë, në këtë rast trupa gjyqësore që adresohet nga vendimi unifikues dhe merr njoftim për të formalisht përmes fletore zyrtare.

Për t'u kthyer tek vendimet e GJK, sa kohë ato shpallen të arsyetuara në seancë, në prani të palëve, të cilat marrin dijeni në sallë për këtë vendim, hyrja në fuqi e tyre përmes botimit në FZ veçse komplikon procesin, sidomos kur vendimi i GJK lidhet me rrëzimin e ANFL të cilave kanë filluar të prodhojnë efekte që nga momenti i nxjerrjes së tyre. Hyrja në fuqi e vendimeve të GJ duhet të ndahet nga botimi i tyre në FZ; botimi mund të realizohet në një kohë të dytë nga hyrja në fuqi e vendimit, në mënyrë që edhe palë të tjera të interesuara të marrin dijeni mbi normën / jurisprudencën më të re të GJK. Në këtë mënyrë, parimi i reduktimit të dëmit që pas sjell një akt juridiko-administrativ i nxjerr jo në përputhje me Kushtetutën, mund të aplikohet më mirë për shkak të aktivizimit më të shpejtë në kohë të normës ndaluese (vendimi IGJK)

Afatet e gjykimit kushtetues mbi ANFL

Do ishte logjike dhe e dobishme të pretendohet gjithashtu që, kur GJK shqyrton kushtetutshmërinë e ANFL, koha në të cilët realizohet ky kontroll të ishte sa më e shkurtër. Konstatohet se nxjerrja e ANFL është si një sëmundje kronike që "aktivizohet" si rregull në periudhat e instalimit të qeverive të reja pas rotacioneve politike. Pas ardhjes në pushtet të së djathtës 2005, GJK gjeti në mos-pajtim me Kushtetutën mbi gjysmë duzinë aktesh normative të qeverisë Berisha nxjerrë brenda 12 muajve të parë të mandatit të saj. Me sa duket, qeveritë, në statet parake, nuk rriten dot pa "pirë qumështin" e dekretligjeve, sado toksike që mund të rezultojnë më pas efektet e tyre pas kontrollit kushtetues të ushtruar nga GJK.

Çështja e afateve për hyrjen në fuqi të vendimeve të GJ është një "ngërç procedural" paralizues krahasuar më shpejtësisë me të cilën Qeveria mund të nxjerrë dhe futë në veprim dekretligjet e saj (ANFL), por çështja e prapësimit me vendim të GJK të efekteve të prodhuara nga ANFL është pothuajse një mision i pamundur. Dëmi i supozuar mund të jetë shkaktuar tashmë, për shkak të natyrës së vetë ANFL, ndërkohë që mekanizmat parandalues për dëmin (real ose të supozuar) janë inekzistent. Adresimi për zgjidhje në rrugën normale të shqyrtimit gjyqësor në gjykatat e zakonshme, është një opsion i cili ngjall pak optimizëm edhe tek pala direkt e dëmtuar. Shembja e nën-kalimi të Zogut të Zi, pasojë direkte e një akti normative me fuqinë e ligjit të KM, nuk është rikuperuar as sot e kësaj dite në terma të adresimit të fajësisë, (zh)bërjes së dëmit, apo kompensimit të drejtë financiar.

Këto efekte, mund të ishin sadopak të frenueshme nëse GJK do t'i caktohej apo kërkohej në ligj detyrimi që ANFL të shqyrtoheshin prej saj, kryesisht ose me kërkesë "të ngutshme" nga një palë e legjitimuar, para ose paralelisht me procesin legjislativ që aktivizohet në Kuvend. Një atribut të tillë GJK e ka kur shqyrton pajtueshmërinë me Kushtetutën të marrëveshjeve ndërkombëtare, para ratifikimit të tyre nga Kuvendi (Neni 52/1). Në një rast të tillë, pra të ushtrimit të kontrollit kushtetues *ex-ante*, ligji organik 8577/2000 i cakton asaj 1 muaj afat të vendosë për marrëveshjen, duke pezulluar gjatë kësaj kohe procesin legjislativ të ratifikimit, nëse ky ka nisur ndërkohë në Kuvend. Në fakt, ky ka qenë rasti "fatlum" i shfuqizimit paraprakisht nga GJK të asaj që njihet si "Marrëveshja e Detit" mes Shqipërisë e Greqisë.

Kushtetuta ka të parashikuar në nenin 115 të saj edhe rastin kur Këshilli i Ministrave mund të shkarkojë organet e zgjedhura të Qeverisjes vendore. Edhe në këtë rast, "*Organi i shpërndarë ose i shkarkuar mund të ankohet në Gjykatën Kushtetuese brenda 15 ditëve, dhe në këtë rast vendimi i Këshillit të Ministrave pezullohet*" (neni 115/2).

Njësoj si për marrëveshjet ndërkombëtare para ratifikimit, apo VKM të cilat shpërndajnë organet e qeverisjes vendore, edhe për ANFL, Gjykata Kushtetuese duhet të lejohet të vlerësojë përputhshmërinë e tyre me Kushtetutën, para se efektet e prodhuara të intensifikohen deri në pakthyeshmëri. Analogjia në këtë rast është e evidente: projekt-marrëveshjet ndërkombëtare inicohen nga Ekzekutivi dhe pasi formësohen si VKM ato i dërgohen Kuvendit për ratifikim. Po ashtu e edhe shpërndarja e një organi të qeverisjes vendor, realizohet përmes po të njëjtit instrument, pra VKM-së. Madje, në këtë rast, meqë VKM adreson një subjekt konkret të së drejtës dhe nuk cakton rregulla të përgjithshme sjelljeje, ajo është akt me karakter të pastër individual (për këtë arsye parashikohet nga ligji të fillojë efektet menjëherë²⁶). Edhe një ANFL, pavarësisht se është ligj në kuptimin material, në kuptimin formal është një vendimmarrje e Këshillit të Ministrave;

akti implikon Kuvendin si autoritet final adoptues (ratifikues)

Njësoj si të ishte një VKM individuale, ANFL lejohet të hyjë në fuqi menjëherë, dhe më pas, në një kohë të dytë,

kërkohej nga ligji që të botohet edhe në Fletore Zyrtare.

Pra kushtet formale që legjitimojnë një kontroll *ex-ante* edhe për ANFL ekzistojnë në kushtetutë dhe në ligj dhe gjithashtu mbështeten nga praktika .

I vetmi ndryshim në rastin e kontrollit kushtetues *ex-ante* të ANFL ndoshta do të duhej të ishte ngushtimi drastik i afateve brenda të cilave GJK duhet të shprehet. Vetë Kushtetuta i vendos Kuvendit një afat prej 5 ditësh që ai të mblidhet për të marrë në shqyrtim ANFL të nxjerrë nga KM? Madje Kuvendi ka vetë 45 ditë kohë në dispozicion brenda të cilave duhet të shprehet nëse e kthen në ligj apo e rrezon një ANFL (sigurisht Kuvendi mund të zgjedhë të mos bëjë asnjërin nga të dyja dhe ta lërë ANFL të ezaurojë vetvetiu kohën 45-ditore të prodhimit të efekteve juridike).

Neni 29, ligji ligji 9000/2003 "Për organizimin dhe funksionimin e KM": "Vendimet e Këshillit të Ministrave marrin fuqi juridike pasbotimit në Fletoren Zyrtare. Për vendimet me karakter normativ mund të caktohet si datë hyrjeje në fuqi një datë tjetër nga ajo e botimit nëFletoren Zyrtare, ndërsa vendimet me karakter individual hyjnë në fuqi menjëherë, por botohen në Fletoren Zyrtare."

Pra, kushtetutë-bërësi ia ka kufizuar në kohë atributet legjislativitet për t'u shprehur mbi fatin e një ANFL. Në një rast të tillë Kuvendi, ndryshe nga sa mendohet, ushtron atributet e një legjislatori negativ, pasi në secilin rast ai mund ta rrëzojë një ANFL, duke mos e kthyer atë në ligj. Madje edhe kur Kuvendi zgjedh të mos shprehet brenda afatit 45 –ditor, ai më shumë se sa një legjislator “pasiv” është duke ushtruar funksionet e një legjislatori negativ, pasi mosveprimi i tij sjell për pasojë shterimin e efekteve nga ANFL ditën e 45-të pas nxjerrjes së tij.

Konkluzione

Paradoksalisht, Gjykata Kushtetuese, që është gjithashtu një legjislator negativ nuk ka janë kufizim në kohë për shqyrtimin e kushtetutshmërisë të ANFL. Ligjvënësi e ka lënë në diskrecionin e saj, pra pa caktuar një limit ligjor, për t'u shprehur mbi një çështje urgjente, siç është në thelb kontrolli kushtetues mbi një ANFL! Ky raport duhet përmbysur. Vetëm në një rast të tillë, drejtësia e shërbyer nga Gjykata Kushtetuese mund të konsiderohet e efektshme dhe mbi të gjitha e dobishme. Drejtësia e vonuar është drejtësi e munguar, dhe vlerësimi i kushtetutshmërisë së dekretligjeve qeveritare është rasti kur vonesa është disavantazh që pa filluar akoma shqyrtimi gjyqësor rrjedhimisht mungesa e drejtësisë, në kuptimin e efikasitetit të saj, është shumë fort e implikuar.

Në gjykimin e autorit të këtij punimi, afati 5 ditor që Kushtetuta ka vendosur mbi ligjvënësin për t'u mbledhur dhe për të shqyrtuar “fatin” legjislativ të një ANFL, duhet të aplikohet njësoj edhe për Gjykatën Kushtetuese (edhe kjo në këtë rast konsiderohet “ligjvënës negativ”). Si në rastin e marrëveshjeve ndërkombëtare, kontrolli kushtetues ndaj ANFL mund dhe duhet të realizohet ex-ante, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të prodhohen garanci reale që e drejta të përbëjë bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Ky parim i rëndësishëm kushtetuese, një tautologji për Shtetin e së Drejtës, duket se mbështete mbi koncepte që implikojnë një hapësirë juridike më shumë se sa një kohë juridike.

Megjithatë, jashtë përcaktimit kohor, kjo do të ishte e pamundur të arrihej. Hipotetikisht do të mjaftonin vetë disa Akteve Normative me Fuqinë e Ligjit të KM, një shumicë “e bindur” në Kuvend dhe një Gjykatë Kushtetuese që lëviz ngadalë, për të paralizuar rendin juridik deri në dëmtim permanent. A nuk ishin përfaqësuesit ligjorë të Ekzekutivit (Qeverisë) të cilët pohuan prerë përpara gjyqtarëve kushtetues se edhe vetë Kushtetuta mund të ndryshohet me ANFL?! Dhe teorikisht kjo është e mundur....por nëse kontrolli për ANFL do të aktivizohej ex-ante dhe do prioritarizohej nga GJK (ANFL nxirren rrallë), atëherë kjo mundësi teorike do të ishte praktikisht nën kontroll para se të shkaktohte dëm. Kur Noe e ndërtoi arkën e shpëtimit?

Përpara Përmblyjes!

Bibliografia

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
 Luan Omari, “*Shteti i së drejtës*”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002
 Sadushi, Sokol. “*Drejtësia kushtetuese në zhvillim*”, botimet Toena, Tiranë, 2012
 Monteskie, “*Mbi Frymën e Ligjeve*”, Përkthyer nga shtëpia botuese ‘Luarasi’, 2000
 Traja, Kristaq. “*Drejtësia Kushtetuese*”, Shtëpia Botuese “Luarasi”, Tiranë, 2000
 Michel Fromont, “*Sistemet e huaja më të mëdha të së drejtës*”, Shtëpia botuese Papirus, Tiranë, 2009.
 Temistocle Martinez, “*E drejta kushtetuese*”, përkthyer në shqip nga Botimet UET Press, Tiranë, 2011.

MBIKQYRJA ELEKTRONIKE SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR

MIRGEN PRENÇE

Pedagog/Universiteti European i Tiranës

ERVIS ILJAZAJ

Pedagog/Universiteti European i Tiranës

ABSTRAKT

Punimi trajton mbikëqyrjen elektronike në Shqipëri. Është analizuar zhvillimi historik i mbikëqyrjes elektronike. Është dhënë përkufizimi i mbikëqyrjes elektronike. Janë analizuar rastet e zbatimit të mbikëqyrjes elektronike. Është analizuar procedura e përdorimit të saj, personat që kanë të drejtë të kërkojnë përdorimin e saj. Është trajtuar roli i gjykatës, prokurorisë, Shërbimit të Provës si institucione shumë të rëndësishme në mbikëqyrjen elektronike të subjekteve. Janë pasqyruar eksperiencat e vendeve të zhvilluara si: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Anglia, Franca në lidhje me mbikëqyrjen elektronike. Janë pasqyruar disa argumente se përse është e domosdoshme përdorimi i mbikëqyrjes elektronike në krahasim me alternativën tjetër atë të burgimit.

Fjalë kyç: *Mbikëqyrje elektronike, burgim, dënim, riintegrim social*

Vështrim historik

Pajisja e parë për mbikëqyrjen elektronike u realizua në vitin 1960 nga një psikolog amerikan i quajtur Robert Schweitzgebel¹ por u deshën edhe njëzet e tre vjet që të bëhej realitet një ide e tillë.

Në vitin 1977 gjyqtari Jack Love i erdhi ideja për mbikëqyrjen elektronike të të dënuarve duke u inspiruar nga libri i titulluar “Njeriu merimangë”. Gjyqtari Love punësoi një ekspert për të realizuar një pajisje elektronike dhe në vitin 1983 ai vendosi ndaj një personi masën e sigurimit arrest në shtëpi duke aplikuar për herë të parë mbikëqyrjen elektronike tek një i dënuar². Programet e mbikëqyrjes elektronike zbatohen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britaninë e Madhe dhe në mbarë botën për të ulur mbipopullimin e burgjeve³.

Mbikëqyrja ndihmon në zbatimin e urdhërimeve që përmbajnë vendimet gjyqësore që caktojnë një nga alternativat e dënimit me burgim, dënim plotësues, një nga llojet e masave shtrënguese, një urdhër mbrojtjeje ose një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje. Ky është edhe objekti⁴ që ka mbikëqyrja elektronike.

Ndonëse në Shqipëri mbikëqyrja elektronike ka filluar të funksionojë vonë (mars 2013)⁵, në vende të tjera vihet re se kjo është përdorur më shpejtë dhe këtu mund të përmendim shtete si SHBA që kane filluar ta përdorin që në vitin 1983, Franca filloi përdorimin e mbikëqyrjes elektronike në vitin 1997⁶, Italia⁷ ka filluar ta përdori duke filluar me vitin 2000, Finlanda në vitin 2006⁸.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i punimit është të sqarojë mënyrën se si funksionon mbikëqyrja elektronike në Shqipëri. Analizimi i attributeve të organeve kryesore që kanë lidhje me mbikëqyrjen elektronike. Studimi ka si objektiv të ndihmojë personat që merren me mbikëqyrjen elektronike që të zbatojnë në mënyrën e duhur mbikëqyrjen elektronike.

Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Hipoteza

Aplikimi i mbikëqyrjes elektronike shmanj pasojat negative të burgimit dhe bën që riintegrimin social i individit të realizohet më shpejtë.

Pyetjet kërkimore

Cili është kuptimi i mbikëqyrjes elektronike? Në cilat raste zbatohet mbikëqyrja elektronike? Çfarë roli luan gjykata, prokuroria dhe Shërbimi i Provës në procesin e mbikëqyrjes elektronike?

Metodologjia e punimit

Në punim janë përdorur metodat historike, analitike, krahasimore.

Kuptimi i mbikëqyrjes elektronike

Përkufizimin e mbikëqyrjes elektronike e gjejmë në ligjin e posaçëm që rregullon këtë çështje. Sipas nenit 3 të shkronjës a) të ligjit për mbikëqyrjen elektronike, me mbikëqyrje elektronike ose ME do të kuptojmë mekanizmin që garanton zbatimin efektiv të vendimit gjyqësor, nëpërmjet përcaktimit në kohë reale të vendndodhjes së një personi, me anë të përdorimit të mjeteve elektronike të vendosura në trupin e tij.

Gomme I. M. From big house to big brother: Confinement in the future. Canadian Scholar's Press. Toronto, 1995, fq. 489-517.

Gomme I. M. From big house to big brother: Confinement in the future. Canadian Scholar's Press. Toronto, 1995, fq. 489-517.

<http://www.johnhoward.ab.ca/pub/A3.htm>, 20.02.2015.

Neni 1 Ligjit nr. 10494. Date 22.12.2011, Per mbikëqyrjen elektronike te personave, te cileve u kufizohet levizja me vendim gjyqësor.

Mbikëqyrja elektronike, shkarkuar nga: <http://sherbimiprovës.gov.al/index.php/al/2011-05-02-12-33-12/9-menu/46-mbikëqyrja-elektronike>, ne 22.02.2015.

Béatrice Geninet, *L'indispensable du droit penal*, Studyrama, Paris, 2004, fq. 112.

Massimo Niro, Massimiliano Signorini, *Arresti domiciliari e detenzione domiciliarre*, CEDAM, Padova, 2010, fq. 103.

Petri Danielsson, Leena Mäkipää, *A systematic literature review of electronic monitoring of offenders*. Helsinki, 2012, fq. 91. Shkarkuar nga: <http://www.optula.om.fi/material/attachments/optula/julkaisut/tutkimustiedonantoja-sarja/Z5cTvklcz/>

Summary_SystematicLREMO. pdf, ne 22.02.2015.

Rastet e zbatimit të mbikëqyrjes elektronike

Mbikëqyrja elektronike zbatohet në rastet kur me vendim gjyqësor është vendosur:

Njëra nga këto masa shtrënguese: a) ndalimi i daljes jashtë shtetit, b) ndalimi dhe detyrimi për qëndrim në një vend të caktuar, c) arresti në shtëpi.

Njëri nga këto dënime alternative: a) gjysmë liria, b) pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë, c) qëndrimi në shtëpi, d) lirim me kusht.

Kur vendoset dënimi plotësues i ndalimit për të qëndruar në një ose disa njësi administrative.

Kur është lëshuar me vendim gjyqësor një urdhër mbrojtjeje ose një urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje sipas neneve 17 dhe 19 të ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Me hyrjen në fuqi të Udhëzimit të Përbashkët nr. 827/7, datë 28.02.2013 filloi zbatimi i projektit pilot për përdorimin e mbikëqyrjes elektronike ndaj subjekteve që gjykohen në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatën e Apelit Tiranë, kurse me vendimin nr. 406 të Këshillit të Ministrave datë 18.6.2014 “Për shtrirjen e mbikëqyrjes elektronike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë” është vendosur që mbikëqyrja elektronike e personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor, të parashikuar në nenin 4, të ligjit nr. 10494, datë 22.12.2011, shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Përdorimi i mbikëqyrjes elektronike

Gjykata vendos përdorimin e mbikëqyrjes elektronike kryesisht ose me kërkesën e prokurorit, subjektit, avokatit të tij, të dëmtuarit nga vepra penale, viktimës apo prindërve ose kujdestarit të të miturit.

Për të mbrojtur jetën private të individit kërkohet shprehja e vullnetit të individit për aplikimin e mbikëqyrjes elektronike⁹. Si rregull përdorimi i mbikëqyrjes elektronike vendoset vetëm me pëlqimin e subjektit dhe pasi gjykata sigurohet se personi i kupton të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga përdorimi i mbikëqyrjes elektronike. Dhënia e pëlqimit nga subjekti mund të jepet me shkrim ose me gojë nëpërmjet deklaratimit në seancë gjyqësore. Në rastin e personave të mitur duhet të japi pëlqimin prindi ose kujdestari. Nëse subjekti nuk jep pëlqimin, gjykata si rregull nuk mund të urdhërojë përdorimin e mbikëqyrjes elektronike, por mosdhënia e pëlqimit të subjektit mund të ketë ndikim negativ në përcaktimin e masës shtrënguese ose të dënimit sepse gjykata mund të japi një masë shtrënguese më të rëndë apo mund të mos aplikojë asnjë nga dënimet alternative.

Në mënyrë përjashtimore gjykata mund të vendosë përdorimin e mbikëqyrjes elektronike edhe pa pëlqimin e personit¹⁰ ndaj të cilit vendoset mbikëqyrja kur është lëshuar me vendim gjyqësor një urdhër mbrojtjeje ose një urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje sipas neneve 17 dhe 19 të ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” kur plotësohen dy kushtet e mëposhtme:

kur është e domosdoshme për të garantuar të drejtat kushtetuese të personave të tretë ekziston dyshimi i arsyeshëm i mbështetur në prova se subjekti paraqet rrezikshmëri për cenimin e këtyre të drejtave.

Vendimi gjyqësor që urdhëron përdorimin e mbikëqyrjes elektronike midis të tjerave duhet të përmbajë: a) dhënien e pëlqimit nga subjekti, kur këtë e kërkon ligji, dhe/ose prindërit ose kujdestari i të miturit për përdorimin e mbikëqyrjes elektronike; b) zonat e lejuara dhe zonat e ndaluara të lëvizjes së subjektit; c) detyrimin e subjektit për të qëndruar brenda zonës së lejuar ose për të mos hyrë në zona të ndaluara; ç) afatin kohor të përdorimit të mbikëqyrjes elektronike në rastet kur gjykata urdhëron përdorimin e saj sipas një afati të caktuar kohor.

Në lidhje me mbikëqyrjen elektronike në doktrinë me të drejtë është mbajtur qëndrimi që është një lloj forme kontrolli në distancë¹¹. Është gjyqtari ai që vendos se si duhet të realizohet mbikëqyrja elektronike.

Mbikëqyrja elektronike është një mënyre kontrolli konstante e lëvizjeve të personit¹². Ky kontroll realizohet me vendosjen e një byzylyku.

Qëllimi i rritjes së rasteve të mbikëqyrjes elektronike bëhet shpesh për të zvogëluar rrezikun për sigurinë publike, por kur përdoret si një alternativë ndaj burgimit, qëllimi i aplikimit të mbikëqyrjes elektronike është zakonisht për të reduktuar recidivizmin duke shmangur pasojat negative të burgimit si socializimi me nënkulturat kriminale, humbja e mundësisë së punësimit ose e studimit¹³, ulja e shpenzimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve¹⁴

Paolo Tonini, *Lineamenti di diritto processuale penale*, Giuffrè, Milano, 2012, fq. 202.

Neni 7 i Ligjit nr. 10494. Date 22.12.2011, Per mbikeqyrjen elektronike te personave, te cileve u kufizohet levizja me vendim gjyqesor.

Ercle Aprile, *Le misure cautelari nel processo penale*, Giuffrè, Milano, 2006, fq. 88.

Claudio Coratella, *Processo penale*, GRUPPO24ORE, Milano, 2012, fq. 81.

Petri Danielsson, Leena Mäkipää, *A systematic literature review of electronic monitoring of offenders*. Helsinki, 2012, fq. 91. Shkarkuar nga: http://www.optula.om.fi/material/attachments/optula/julkaisut/tutkimustiedonantoja-sarja/Z5cTvklcz/Summary_SystematicREMO.pdf, ne 22.02.2015.

John Bourn, Aleksandra Botten, Phil Gibby, Vicky Inglese, Clare McGovern, Bryony Randall, Aileen Murphie, *The electronic monitoring of adult offenders*, Londer, 2006, fq. 2. Shkarkuar nga: <http://www.nao.org.uk/wp-content/uploads/2006/02/0506800.pdf>, ne 21.02.2015.

Roli i gjykatës në mbikëqyrjen elektronike

Gjykata ka një rol shumë të rëndësishëm në mbikëqyrjen elektronike sepse është organi që vendos për lejimin e mbikëqyrjes elektronike nëse bëhet fjalë për një nga rastet e fushës së zbatimit të mbikëqyrjes elektronike të parashikuara në nenin 4 të ligjit që trajton mbikëqyrjen elektronike dhe nëse plotësohen edhe kërkesat e tjera të parashikuara në ligj. Në rast se subjekti nuk respekton kushtet e përcaktuara në vendimin gjyqësor, gjykata pasi dëgjon prokurorin, përfaqësuesin e Shërbimit të Provës e subjektin dhe, pasi vlerëson të gjitha rrethanat, vendos nëse mbikëqyrja elektronike duhet vazhduar apo duhet ndërprerë.

Roli i prokurorit në mbikëqyrjen elektronike

Neni 6 i Ligjit “Për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor” i jep të drejtë prokurorit të kërkojë vendosjen e një individi nën mbikëqyrje elektronike por nuk përcakton kriteret që duhet të ketë parasysh prokurori, por këtë çështje e zgjidh Udhëzimi i Përbashkët nr. 827/7, datë 28.02.2013, i firmosur nga Ministri i Drejtësisë, Ministri i brendshëm dhe Prokurori i Përgjithshëm. Prokurori mund të kërkojë vendosjen e mbikëqyrjes elektronike të personave që paraqesin rrezikshmëri të ulët shoqërore ku përfshihen personat e mitur dhe ata që akuzohen për një vepër që dënohet në maksimum jo më tepër se 5 vjet si dhe ndaj personave të cilëve është lëshuar, me vendim gjyqësor, një urdhër mbrojtjeje ose një urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, sipas neneve 17 dhe 19 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar¹⁵. Prokurori mbikëqyrur procedurën e vendosjes dhe të heqjes së pajisjes, rregullshmërinë e funksionimit të saj, si dhe kërkon informacione mbi ekzekutimin e vendimit gjyqësor nga Shërbimi i Provës.

Roli i Shërbimit të Provës në mbikëqyrjen elektronike

Në vendin tonë organi që realizon vendosjen, heqjen dhe funksionimin e rregullt të pajisjes për mbikëqyrjen elektronike është Shërbimi i Provës. Shërbimi i Provës mbikëqyr përbushjen e detyrimeve dhe të kushteve të përcaktuara në vendimin e gjykatës, asiston dhe këshillon subjektin në përbushjen e këtyre detyrimeve dhe e ndihmon në riintegrimin social të tij. Shërbimi i Provës mban kontakte të vazhdueshme telefonike, me subjektet nën mbikëqyrje elektronike, duke i kujtuar atij detyrimet ligjore për respektimin e kushteve të mbikëqyrjes elektronike, si dhe duke e inkurajuar dhe përgëzuar atë për zbatimin e këtyre kushteve. Shërbimi i Provës ka detyrimin ligjor që të informojë në mënyrë periodike Ministrinë e Drejtësisë për kontrollin e ushtruar. Ky institucion vendos çdo javë në dispozicion të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe gjykatave të apelit, të dhëna për numrin e pajisjeve që ka në dispozicion për përdorim. Pajisja nuk vendoset dhe hiqet nga çdo punonjës i shërbimit të provës por vetëm nga personat e autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës¹⁶. Shërbimi i Provës, menjëherë sapo njihet me vendimin gjyqësor, merr kontakte me Policinë e Shtetit, duke kërkuar bashkëpunimin për vëzhgimin e subjektit ndaj të cilit është vendosur realizimi i mbikëqyrjes elektronike, si dhe në rast se paraqitet nevoja, ndihmën e tyre për ekzekutimin e vendimit. Nëse personi nuk paraqitet në vendin dhe kohën e përcaktuar në Urdhrin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, të nxjerrë nga prokurori apo gjykata, i cili përmban vendin dhe kohën për vendosjen dhe heqjen e pajisjes, Shërbimi i Provës njofton menjëherë Policinë e Shtetit dhe Prokurorin. Shërbimi i Provës merr të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit dhe bashkëpunon, sipas rastit, me autoritetet e pushtetit vendor, shërbimet sociale, organet vendore të policisë, si dhe subjekte të tjera, private dhe shtetërore. Shërbimi i Provës siguron informacionin dhe asistencën e nevojshme për subjektin nga institucionet shëndetësore, institucionet e ndihmës sociale, si dhe organizatat joqeveritare që bashkëpunojnë me të¹⁷. Kur subjekti nuk është në gjendje të përbushë detyrimet e vendosura nga gjykata, për shkak të ndryshimit të rrethanave, Shërbimi i Provës njofton menjëherë prokurorin. Shërbimi i Provës mund t'i propozojë prokurorit ndryshimin, sipas ligjit, të kushteve dhe detyrimeve të subjektit, pasi verifikon faktet dhe rrethanat e mos përbushjes së tyre¹⁸. Me kërkesë të gjykatës ose të prokurorit, Shërbimi i Provës përgatit një raport për zbatimin e vendimit të gjykatës dhe ecurinë e procesit të mbikëqyrjes elektronike¹⁹. Kur subjekti nuk përbush kushtet dhe detyrimet e përcaktuara nga gjykata, Shërbimi i Provës paraqet raport para prokurorit²⁰.

Neni 4 i Udhëzimit të Përbashkët nr. 827/7, date 28.2.2013, Për bashkëpunimin ndërinstitucional, në kuadër të realizimit të mbikëqyrjes elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

Neni 9 i Udhëzimit të Përbashkët nr. 827/7, date 28.2.2013, Për bashkëpunimin ndërinstitucional, në kuadër të realizimit të mbikëqyrjes elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

Neni 12 Neni 9 i Udhëzimit të Përbashkët nr. 827/7, date 28.2.2013, Për bashkëpunimin ndërinstitucional, në kuadër të realizimit të mbikëqyrjes elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

Neni 13 Neni 9 i Udhëzimit të Përbashkët nr. 827/7, date 28.2.2013, Për bashkëpunimin ndërinstitucional, në kuadër të realizimit të mbikëqyrjes elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

Neni 15 Neni 9 i Udhëzimit të Përbashkët nr. 827/7, date 28.2.2013, Për bashkëpunimin ndërinstitucional, në kuadër të realizimit të mbikëqyrjes elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

Neni 16 Neni 9 i Udhëzimit të Përbashkët nr. 827/7, date 28.2.2013, Për bashkëpunimin ndërinstitucional, në kuadër të realizimit të mbikëqyrjes elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

Mbikëqyrja elektronike në Francë

Mbikëqyrja elektronike mund të vendoset gjatë zhvillimit të hetimit, mund të vendoset si masë sigurimi shtrënguese. Në sistemin francez, mbikëqyrja elektronike mund të vendoset edhe si dënim²¹. Në Francë aplikimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike është i ndryshëm nga ai i Britanisë së Madhe, sepse në Francë mund të përdoret vetëm për dënime ku të dënuarit mund të përfitojnë liri me kusht ose gjysmë liri, që do të thotë se përdorimi lejohet vetëm për të dënuar që kanë dënime të vogla ose për dënime që janë gati të përfundojnë²². Personat përgjegjës në Francë që merren me mbikëqyrjen elektronike janë: gjyqtari që merret me ekzekutimin e dënimit, këshilltarët e burgjeve dhe të shërbimit të provës²³.

Mbikëqyrja elektronike në Angli

Për herë të parë në Angli mbikëqyrja elektronike u përdor në fillim të vitit 1980 nga një individ privat, i quajtur Tom Stacey si një mënyrë më efektive për të kontrolluar të dënuarit. Në fillim Ministria e Brendshëm në Angli e refuzoi si ide përdorimin e mbikëqyrjes elektronike, por drejtuesit e ministrisë ndërruan mendje pasi panë se si funksiononte skema amerikane. Projekti i parë pilot në Angli realizohet në vitin 1991²⁴. Duhet përmendur fakti se deri në vitin 2006 në rreth 300.000 persona është aplikuar mbikëqyrja elektronike²⁵. Ndonëse në vende të tjera të Evropës autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen elektronike është një institucion shtetëror p.sh. në Belgjikë, në Suedi, në Angli këtë detyrë e realizojnë kompanitë private²⁶. Anglia dhe Uellsi kanë numrin më të lartë në Evropë të personave që janë nën mbikëqyrje elektronike, 40 persona në 100.000 banorë²⁷.

Mbikëqyrja elektronike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë përdorur për herë të parë në botë mbikëqyrjen elektronike. Gjatë viteve mbikëqyrja elektronike ka njohur transformime të mëdha²⁸. Mbikëqyrja elektronike përdoret gjatë hetimeve paraprake, në dënimet alternative. Më shumë se 5 milion persona janë nën mbikëqyrje elektronike në SHBA dhe numri i personave pritet të rritet me kalimin e kohës sepse shtetet e shikojnë si më pakë të kushtueshme sesa vuajtja e dënimit në burg²⁹. Në SHBA mbikëqyrja elektronike mund të zgjas edhe gjatë gjithë jetës së personit³⁰, ndryshe nga legjislacioni jonë ku afati kohor është shumë më i shkurtër. Ndryshe nga mbikëqyrja elektronike që aplikohet në Shqipëri, ku shpenzimet mbulohen nga shteti, në SHBA³¹ ato mbulohen nga personat që iu aplikohet mbikëqyrja elektronike. Në vitin 2010 në SHBA dhe në Evropë për më tepër se 500.000 persona është aplikuar mbikëqyrja elektronike³².

Konkluzione

Mbikëqyrja elektronike ka funksione të shumta, disa nga këto funksione janë: ulja e mbipopullimit të burgjeve, eliminimin e efekteve negative të burgjeve, riintegrimin e shpejtë të individëve, uljen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit sepse kostoja e aplikimit të mbikëqyrjes elektronike është më e ulët sesa e një të dënuari që është duke vuajtur dënimin në burg. Numri i raste të mbikëqyrjes elektronike në botë sa po vjen e po rritet për shkak të efekteve pozitive që ka mbikëqyrja elektronike. E njëjta gjë duhet të realizohet edhe në Shqipëri sepse shërben për riintegrimin e shpejtë të individit dhe bën që të jetë i dobishëm për shoqërinë.

Bracelet electronique dans le cadre d'une assignation a residence, shakarkuar nga:

<http://vosdroits.service-public.fr/particuliers/F2007.xhtml> ne 24.02.2015.

Dirk van Zyl Smit, Frieder Dunkel, *Imprisonment Today and Tomorrow: International Perspectives on Prisoners' Rights and Prison Conditions*, Kluwer Law International, Hage, 2001, fq. 254.

Camille Allaria, *Le placement sous surveillance électronique: espace et visibilité du châtime virtual*, Champ Pénal, vol. 11, 2014, fq. 123.

Rob Canton, David Hancock, *Dictionary of Probation and Offender Management*, Willan Publishing, Devon, 2007, fq. 116.

Rob Canton, David Hancock, *Dictionary of Probation and Offender Management*, Willan Publishing, Devon, 2007, fq. 116.

Rob Canton, David Hancock, *Dictionary of Probation and Offender Management*, Willan Publishing, Devon, 2007, fq. 116.

Mike Nellis, Kristel Beyens, Dan Kaminski, *Electronically monitoredpunishment: international and critical perspectives*, Routledge, Abingdon, 2013, fq. 2.

Mike Nellis, Kristel Beyens, Dan Kaminski, *Electronically monitoredpunishment: international and critical perspectives*, Routledge, Abingdon, 2013, fq. 35.

William Bales, Karen Mann, Thomas Blomberg, Gerry Gaes, Kelle Barrick, Karla Dhungana, Brian McManus, *A Quantitative and qualitative assessment of electronic monitoring*, 2010, fq. 150. Shkarkuar nga: <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/nij/grants/230530.pdf>, ne 12.01.2015.

William Bales, Karen Mann, Thomas Blomberg, Gerry Gaes, Kelle Barrick, Karla Dhungana, Brian McManus, *A Quantitative and qualitative assessment of electronic monitoring*, 2010, fq. 1. Shkarkuar nga: <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/nij/grants/230530.pdf>, ne 12.01.2015.

³¹ Ralph Daugherty, *Murder oN A Hourse Trail: The Disappearance of Chandra Levy*, iUniverse, Inc. Lincoln, fq. 251.

Rafael Di Tella, *Criminal recidivism after prison and electronic monitoring*, Journal of Political Economy, vol. 121, nr. 1, fq. 29.

Bibliografia

Libra, revista

- Béatrice Geninet, *L'indispensable du droit penal*, Studyrama, Paris, 2004.
- Camille Allaria, *Le placement sous surveillance électronique: espace et visibilité du châtement virtual*, Champ Pénal, vol. 11, 2014.
- Claudio Coratella, *Processo penale*, GRUPPO24ORE, Milano, 2012.
- Dirk van Zyl Smit, Frieder Dunkel, *Imprisonment Today and Tomorrow: International Perspectives on Prisoners' Rights and Prison Conditions*, Kluwer Law International, Hage, 2001.
- Erocle Aprile, *Le misure cautelari nel processo penale*, Giuffrè, Milano, 2006.
- Gomme I. M. *From big house to big brother: Confinement in the future*. Canadian Scholar's Press. Toronto, 1995.
- Massimo Niro, Massimiliano Signorini, *Arresti domiciliari e detenzione domicialre*, CEDAM, Padova, 2010.
- Mike Nellis, Kristel Beyens, Dan Kaminski, *Electronically monitoredpunishment: international and critical perspectives*, Routledge, Abingdon, 2013.
- Paolo Tonini, *Lineamenti di diritto processuale penale*, Giuffrè, Milano, 2012.
- Rafael Di Tella, *Criminal recidivism after prison and electronic monitoring*, Journal of Political Economy, vol. 121, nr. 1.
- Ralph Daugherty, *Murder oN A Hourse Trail: The Disappearance of Chandra Levy*, iUniverse, Inc. Lincoln.
- Rob Canton, David Hancock, *Dictionary of Probation and Offender Management*, Willan Publishing, Devon,

2007. Burime elektronike

- Bracelet électronique dans le cadre d'une assignation a residence*, shakarkuar nga:
http://vosdroits.service-public.fr/particuliers/F2007_xhtml ne 24.02.2015
- John Bourn, Aleksandra Botten, Phil Gibby, Vicky Inglese, Clare McGovern, Bryony Randall, Aileen Murphie, *The electronic monitoring of adult offenders*, Londer, 2006, fq. 2. Shkarkuar nga:
<http://www.nao.org.uk/wp-content/uploads/2006/02/0506800.pdf>, ne 21.02.2015.
- Mbikqyrja elektronike, shkarkuar nga: <http://sherbimiproves.gov.al/index.php/al/2011-05-02-12-33-12/9-menu/46-mbikeqyrja-elektronike>, ne 22.02.2015.
- Petri Danielsson, Leena Mäkipää, *A systematic literature review of electronic monitoring of offenders*. Helsinki, 2012, fq. 91.
 Shkarkuar nga: http://www.optula.om.fi/material/attachments/optula/julkaisut/tutkimustiedonantoja-sarja/Z5cTvkclz/Summary_SystematicREMO.pdf, ne 22.02.2015.
- William Bales, Karen Mann, Thomas Blomberg, Gerry Gaes, Kelle Barrick, Karla Dhungana, Brian McManus, *A Quantitative and qualitative assessment of electronic monitoring*, 2010, fq. 1. Shkarkuar nga:
<https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/nij/grants/230530.pdf>, ne 12.01.2015.

PARAQITJET E SHQIPËRISË SË TRANZICIONIT PËR AUDIENCAT PERËNDIMORE

DR. BELINA BUDINI

Përgjegjëse e Departamentit të Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike, Universiteti Europian i Tiranës

ABSTRACT

The main argument of this paper focused on the western media representations of Albania, is that the subject of Albania is constructed and represented in a constant pathway between the years of transition. Time Magazine sets out as a case study on this regard. The object of study is systematically researched and investigated building on the media content analysis and the analysis of the media agency per se. With regard to the content analysis, the quantitative data show that the place and space given to the subject of Albania in rubrics, topics, frequency and angles of coverage are constant over time. The textual analysis in qualitative terms speaks of similar textual constructions and representations from one period of study to the other. The dominant discourse is that of an Albanian abnormality combined with the broader discourse of the American Superiority. A range of consistent media frames and repetitive topics have been identified, surpassing the historical time lag. Such a similarity is found in the journalistic writing and the language used to speak about the subject of Albania in the articles of Time Magazine in terms of synonymy, epithets, metaphors, key words and phrases.

Key words: *Western Press Representations of Albania; International Report, Time Magazine, Discourse of Albanian Abnormality, Media Construction of Foreign News*

“Shqipëria” që mediat perëndimore paraqesin mund të mos jetë Shqipëria që ne duam dhe madje as Shqipëria që ne njohim, së brendshmi. Nevoja për ta njohur, kuptuar dhe shpjeguar perspektivën e mediave dhe audiencave të huaja në raport me subjektin e vendit tim, ishin arsye të mjaftueshme për të ndërmarrë kërkime të thelluara e sistematike jo të Shqipërisë sime apo tonës, por Shqipërisë së të tjerëve, të të huajve. Në spektrin e mediave perëndimore, për vetë rëndësinë e tyre, zgjodha mediat amerikane dhe përzgjedha si rast studimi revistën TIME, një lloj “butik mediatiq” ku janë ekspozuar historikisht edhe “ornamentet” e temës shqiptare.

Gjetjet ishin të atilla që i tejkaluan në kohë dhe shtrirje të gjitha hamendësimet e mia paraprake. Vijmësia e një pamje, një mënyre të ndërtuar dhe të paraqitur të Shqipërisë për një trajektore kohore mjaft të gjatë, që nga viti 1923 dhe deri sot, konfirmon jo vetëm ekzistencën e një Shqipërie tjetër, në sytë e audiencave të huaja, por edhe ngulitjen e një forme të ndërtuar dhe të paraqitur të saj.

Pamja e krijuar është ajo e një vendi përherë të trazuar dhe anormal, pavarësisht nëse flasim për periudha historike me tipare thelbësisht të ndryshme. Kështu e sheh revista TIME Shqipërinë e ilustruar me Ahmet Zogun, dhe hera herës edhe me Faik Konicën apo Fan Nolin. Kështu vijon ta shohë edhe Shqipërinë e ilustruar me Enver Hoxhën dhe nganjëherë me Mehmet Shehun dhe Hysni Kapon. Madje kështu vazhdon ta shohë edhe Shqipërinë e sotme, të ilustruar me politikanët aktualë.

Shqipëria aktuale për të cilën flet revista TIME vijon të jetë një Shqipëri kaotike, e çuditshme dhe konfliktuale, e cila kalon nga një krizë në tjetrën. Për pasojë, i tillë është përfytyrimi i krijuar edhe për vendin dhe njerëzit në tërësi, ashtu si edhe për peizazhin urban dhe rural shqiptar, madje edhe për karakteristikat gjeografike dhe antropologjike.

Në sfond historik, periudha e tretë e punimit, ajo nga viti 1990 deri në vitin 2013 ofroi një tablo botërore ndryshimesh, me përfundimin e Luftës së Ftohtë dhe rënien e komunizmit në botën e lindjes ku bënte pjesë edhe Shqipëria. Anormaliteti i kësaj periudhe, në këtë kuptim, mund të pritej të ishte një lloj normaliteti i ri. Mirëpo ligjërimi i mediave të huaja dhe i revistës Time, për këtë periudhë, vijon të jetë ai i anormalitetit shqiptar, një anormaliteti të vjetër pra. Kujtojmë se edhe në kontekstin e zhvillimeve botërore me Shqipërinë e rreshtuar në kampin komunist, gjatë periudhës së mëparshme, notat e ligjërimin ishin pikërisht ato të anormalitetit shqiptar. Madje këto lloj paraqitjesh mediatike mbizotëronin edhe përpara Luftës së Dytë Botërore. Nga një këndvështrim krahasues sipas periudhave kohore, vihet re megjithatë se ligjërimi i anormalitetit shqiptar është thelluar më tej gjatë periudhës së regjimit komunist, duke u ricikluar edhe pas viteve '90.

Ligjërimi i anormalitetit shfaqet pra rregullisht përgjatë periudhës së fundit, duke nisur me artikujt dedikuar Shqipërisë fill pas rënies së regjimit komunist në fillim të viteve '90, duke vijuar me mbulimin e vitit të trazuar 1997, pa përjashtuar as artikujt që prekin Shqipërinë në kuadër të Luftës së Kosovës në vitin 1999 dhe deri në vitin 2011 kur sërish shfaqet skenari i krizës dhe anormalitetit politik në vend me protestën e 21 janarit në sfond.

Formulimet ekstremizuese që karakterizojnë mënyrën e të paraqiturit të Shqipërisë gjatë regjimit komunist, karakterizojnë gjithashtu edhe ligjërimin e anormalitetit që përbën mënyrën e paraqitjes së Shqipërisë edhe për periudhën e re, atë pas-komuniste. Kështu, ndërsa në periudhën pararendëse Shqipëria cilësohej si “vendi më i zymtë dhe i izoluar prapa Perdes së Hekurt”, të njëjtat nota ekstremizuese në ligjërim vihen re edhe në periudhën pas-komuniste, ku Shqipëria cilësohet si “shteti i harruar ballkanik i Shqipërisë, një nga më të varfrit e Europës” në një artikull të vitit 1997, ndërsa më herët, në vitin 1990 cilësohej “Vendi më i varfër dhe më i prapambetur i Kontinentit ; por skenari i anormalitetit mbetet aktual si ligjërim për Shqipërinë edhe në vitet 2000 kur Time e përshkruan kështu Shqipërinë: “Shqipëria e vockël doli nga diktatura komuniste në 1990 vetëm për t’iu përlulur një bote të ashpër gangsterësh, makinacionesh financiare mashtruese dhe qeverisjeje të paafte, e nëpërkëmbur nga kapitalizmi pa rregulla dhe politika moskokëçarëse”.

Arsyet që gjenden për të mbuluar Shqipërinë, sidomos në fillim të viteve '90, lidhen pikërisht me karakterin përjashtimor që Time u jep ngjarjeve ose zhvillimeve nga Shqipëria, si në artikullin me titull po aq përjashtimor “Shqipëria dhe pas saj nuk mbetet më asnjë”, artikull që hapet me pohimin përjashtimor sipas të cilit “Vetëm një qeveri komuniste në Europë arriti ta përmbante tërmetin politik. Tani, gjashtë muaj më pas, lidhshipi i Shqipërisë së vockël po e liron më së fundi darën e vet të stalinizmit ultra-ortodoks”.

Faktet përjashtimorë nënvizohen edhe në artikullin e korrikut 1990 me titull “Shqipëria, tjetra në radhë për të rënë?”, artikull i cili thekson se “Kur qindra shqiptarë u përballën me të shtënat e armëve të policisë javën e shkuar për të kërkuar strehim në një duzinë ambasadash të huaja në Tiranë, të paktë ishin diplomatët që e vunë në dyshim dëshirën e tyre për të braktisur bastionin e fundit të komunizmit doktrinar në Europën Lindore”.

Ndërsa në fund të këtij viti, në dhjetor 1990, skenari përjashtimor bëhet më i sigurt në artikullin me titull: “Shqipëria: Mirupafshim Stalinizëm”, që nis kështu: “Rënkimi që u dëgjua javën e shkuar ishte zëri i diktaturës së fundit marksiste të Europës, që hyri në koshin e plehrave të historisë”. Një vit më pas, më 1991, arsyeja për të raportuar rreth Shqipërisë lidhet me faktin tjetër përjashtimor se “Pas dekadash izolimi komunist, Shqipëria mban zgjedhjet e saj të para të lira”.

Të njëjtin vit, në vazhden e dinamikës së ngjarjeve, Time qëmton fakte të tjera përjashtimorë me vlerë lajmi, si në artikullin me titull “Shqipëria: Nuk ka marrë fund ende”, ku nënvizohet fakti se “Edhe pse komunistët fituan një shumicë prej 162 vendesh nga 250 të tilla në Asambleenë Popullore... fitorja e tyre shpërtheu dhunën më të egër që vendi ka parë në më tepër se një vit trazira në rritje”.

Një periudhë tjetër e zhvillimeve nga Shqipëria që merr mbulim është ajo e vitit 1997. Edhe kësaj radhe, arsyeja për të mbuluar Shqipërinë, lidhet sërish me skenarin e anormalitetit të krijuar në vend dhe që Time e përshkruan kështu në artikullin me titull “Toka pa rend dhe pa ligj”: “Europa e ktheu vështrimin në juglindje të vet javën që shkoi për të parë t’i zhduket qytetërimi para sysh. Shqipëria vazhdimisht e mjeruar papritur nuk ishte më një shoqëri e organizuar por në gjendje kaosi. [...] ato që kishin nisur si revolta spontane në disa qytete të jugut e kthyen gjithë vendin në një skenë filmash lufte si ato

të Mad Max: fëmijë që tundin granatat dhe tytat e automatikëve; që i nxjerrin ato në shitje me shumicë; dhe qitje frenetike, të vazhdueshme me armë, një kolaps i vërtetë i autoritetit civil. Shqipëria e vogël, e rrahur nga dielli, është shndërruar në një shtet të Anarkisë” .

Në vend të përfundimeve: Disa qasje propozuese

Qasja e Marrëdhënieve Publike dhe Diplomatie të një vendi në tranzicion si Shqipëria, me burime dhe mundësi të kufizuara, ndryshon krejtësisht nga qasja e një vendi të zhvilluar. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me faktin se prioritetet e tyre strategjike janë krejt të ndryshme. Ky dallim lidhet sidomos me faktin që vendet perëndimore dhe ato në stad tranzicioni kanë target publikë të ndryshëm. Vendet perëndimore ose ato të zhvilluara u drejtohen direkt publikëve të huaj, ndërsa vende si Shqipëria janë më të prirur t'i përqendrojnë komunikimet e tyre dhe i përdorin marrëdhëniet publike ndërkombëtare për të aksesuar qeveritë e huaja dhe aktorët e burokracisë perëndimore.

Është bërë e zakonshme tanimë, sidomos për vendet e Botës së Tretë, që t'ua lënë në dorë firmave të huaja të marrëdhënieve publike (PR) paraqitjen e vendit të tyre. Sigurisht që qëllimi i tyre diktohet nga nevoja e këtyre vendeve për burime financiare dhe ekonomike, duke qenë se lëvizjet e kapitalit janë kryesisht në duart e vendeve të zhvilluara dhe me anë të marrëdhënieve të besimit të vendosura direkt me qeveritë e tyre, aspirojnë të fitojnë mbështetje për zhvillim të qëndrueshëm (Kunczik, 2003). Mirëpo përpjekjet për të fituar së pari publikun e huaj, mund të jenë një mënyrë edhe më efciente për të mbërritur mandej tek qeveritë e këtyre vendeve.

Nuk mund të nënvlerësohet kësaj roli dhe rëndësia e mediave të huaja, si mjete nga më të fuqishmet që garantojnë ekspozimin ndaj publikut të huaj dhe qeverive të tyre, respektivisht. (Wang, 2006).

Anashkalimi i publikut të huaj perëndimor dhe përqendrimi i marrëdhënieve publike ndërkombëtare nga ana e vendeve të pazhvilluara vetëm tek autoritetet qeveritare të vendeve perëndimore shihet si përpjekje e pamjaftueshme për të paraqitur dhe avancuar imazhin pozitiv të një vendi.

Sipas Kunczik (2003) “imazhet e vendeve influencojnë lëvizjet e kapitalit ndërkombëtar” (f3). Të ndërtosh një imazh të besueshëm është “kriter” për të aplikuar për fonde, hua, financime, etj. Sipas këtij autori, “besimi” është faktor i rëndësishëm në mobilizimin e burimeve, si për shembull në marrjen e mbështetjes politike dhe/ose materiale nga një vend tjetër” (f.6). Besimi është pra ekuivalent i parave (f.6).

Qasja e PR-it direkt me qeveritë e huaja

Të nxitur kësaj nga nevoja për të vendosur besim, vendet në zhvillim angazhohen në marrëdhënie publike ndërkombëtare me ndihmën e firmave apo agjencive të huaja të specializuara në PR. Këto agjenci sigurojnë aksesin e autoriteteve dhe zyrtarëve të lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës apo vendeve të tjera të zhvilluara. Nëse në rastin shqiptar duket se kufizohen këtu, me arritjen e ndonjë fotografie apo shtrëngimi duarsh, këto agjenci apo firma PR mund të ndihmojnë gjithashtu në organizimin e vizitave të pjesëtarëve të mediave të huaja në Shqipëri, takime me editorë dhe dreka me grupe biznesi, zhvillime seminaresh dhe tryezash me natyrë financiare dhe ekonomike që trajtojnë çështje të lidhura me oportunitetet dhe mundësitë që ofron vendi pritës, etj.

Qasja e komunikimeve direkte me publikun e huaj

Në një anë, diplomacia tradicionale mbetet ende një rrugë e vlefshme për të zgjidhur dhe avancuar mjaft çështje, sidomos ato me natyrë bilaterale që lidhen me ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të një vendi. Në anën tjetër, i domosdoshëm dhe shpesh i efektshëm mund të jetë edhe përdorimi i mjeteve dhe rrugëve të PR-it për të aksesuar direkt qeveritë e vendeve të zhvilluara nga ana e qeverive të vendeve në zhvillim.

Mirëpo, duket se vetë vendet e zhvilluara nga ana e tyre kanë zgjedhur një qasje tjetër, atë të komunikimeve të hapura drejtuar audiencave dhe publikut të huaj, jo vetëm atij qeveritar por edhe më gjerë. Në fakt, qeveritë e vendeve të zhvilluara gjithnjë e më tepër janë nën trysinë e opinionit publik, ndaj në kushtet kur revolucioni në teknologjitë e informimit dhe të komunikimit bën që lajmet dhe idetë të qarkullojnë më shpejt dhe të shpërndahen më gjerë, këto rrugë nuk mund të injorohen më.

Studiuesit pohojnë se për çdo vend është thelbësore që “të kuptojnë nevojat e publikëve të huaj dhe ta përshtatin strategjinë e tyre të komunikimit, në mënyrë të arsyeshme, me këto audiencat”. (Wang, 2006, f.27).

Duhet marrë pra në konsideratë audiencat publike të këtyre vendeve që përbëhen nga mediat në radhë të parë e mandej nga grupe të ndryshme të publikut të huaj që nga investitorët e financuesit dhe deri tek vetë qeveritarët, pa dyshim.

Bibliografia

- Kunczik, M. (2003). Transnational public relations by foreign governments. In K. Sriramesh & D. Vercic (Eds.), *Handbook of global public relations* (pp. 399-424). Mahwah, NJ: Lawrence Erlbaum.
- Philo C. Wasburn (2002), *The social construction of international news, We're talking about them, they're talking about us*, London: Greenwood Publishing Group.
- Revista Time, “Albania: By Remote Control”, 14 maj 1951.
- Revista Time, “Army Tries to Restore Order in Albania”, 27 janar 1997 (Time.Com).
- Revista Time, “Albania and then there were none”, 21 maj 1990 (Time US).

- Revista Time, "The Trouble with Democracy: Albania's Worrisome Vote, 21 Maj 2011 (Time.Com)
- Revista Time, "Albania and then there were none", 21 maj 1990 (Time US).
- Revista Time, "Albania Next to Fall?", 16 korrik 1990 (Time US).
- Revista Time, "Albania: Goodbye Stalinism", 24 dhjetor 1990 (Time US).
- Revista Time, "Time Magazine Contents Page", 8 prill 1991 (Time US).
- Revista Time, "Albania: It's not over by a long shot", 15 prill 1991 (TIME US). Revista Time, "No Law or Order in the Land"
- Timothy M. Jones, Peter Van Aelst, Rens Vliegthart, Foreign Nation Visibility in U.S. News Coverage A Longitudinal Analysis (1950-2006), Communication Research June 2013 vol. 40 no. 3 417-436
- Wang, J. (2005). Localizing public diplomacy: The role of sub-national actors in national branding. Journal of Place Branding,2.
- Wang, J.(2006). Telling the American story to the world: The purpose of U.S. public diplomacy in historical perspective. Public Relations Review, 33

WIRELESS SENSOR NETWORKS FOR AIR POLLUTION MONITORING

MIMOZA DURRËSI

mimoza.durresi@uet.edu.al

LUCIANA KINI

klesta.96@yahoo.com

ABSTRACT

Living in today's cities is becoming more and more challenging. The air that we breathe is the number one food and that is becoming more polluted every day. The industrial, era brought the pollution era and combined with the high traffic becomes a serious burden in our lungs as well in our lives. Monitoring air pollution in the high traffic zones, having real time data about the critical situations would be very helpful for managing the air quality. In this paper we present a model of using wireless sensor networks for monitoring the air pollution in traffic lights as well in the streets. The ad-hoc wireless air sensor communication protocol that we propose makes it possible to have real time data in the traffic control offices. This information can be used for having real time management of traffic distribution. As by our protocol the sensors installed in several group of cars as well in the traffic lights create a virtual hierarchical infrastructure. The sensors to sensors, sensor to gateway communications are low cost ones, create low network load and low latency during the information collecting process.

Introduction

One of the human's today's challenges is to survive in the new modern environment created from the Industry and agriculture development, the air pollution, toxic wastes evaporated in the air, chemicals entering the water cycle and everything else. These are challenges that the human never faced before and he needs to use tools and techniques that he never used before. From years researcher are working on finding ways on how to measure the air pollution and how to find new ways for alleviating it. We can mention the work done at university of California at San Diego. The computer scientists at UC San Diego [1] built a small group of air pollution sensors, installed those on several smart phone users and monitored the air quality in real time. Such sensors are useful especially for people suffering from asthma, or chemical allergies. People also noticed that the air pollution is not distributed equally, for example it results that in high traffic areas such as lights the air is about 40 times more polluted than along the way. The problem is that the crowded cities are huge, so you have to ask for occasional cooperation not giving the possibility for a systematic, well distributed and well scheduled measurements. On the other hand since the smart phone is a personal device the result will be mixed with the persons' presence not indicating the right measurements for the air polluting elements.

Air pollution monitoring Systems

Recent technological developments brought the possibility to have more systematic, well distributed and real time data transmission studies. Many researchers around the world have contributed in this direction. Here we can mention the School Bus Monitoring Study [31] developed at University of California along with NRDC (National Resources Defense Council). Children's health is the most important and that's why the focus of this study was to analyze the health hazards posed to school children by their exposure to diesel pollutants. Researchers sent the signal to the society for the urgent need for mobile monitoring of air quality in general and the air pollution created from the diesel exhaust. This is a known carcinogen and a cause of respiratory illnesses. In [2] (Faoul) the authors designed and tested an integrated unit that gathers the information from the air sensors and transmits the data to the traditional wireless network. This unit was installed on the top of moving vehicles and the sensors' box gathers and at the same time transmits real-time data giving the air pollution level. This is the advantage brought from this work. In the unit is included the microcontroller that transmits the collected data together with vehicle's coordinates defined from the GPS giving the possibility to localize the data collected. As a result the registered level of toxicity for the specific location and in the very moment can be transmitted through the GPRS to the pollution Server. There are two problems related to this approach. First of all the number of collecting sites is little because depends from the number of volunteers agreeing to use the device and is restricted in the mobile public network area. On the other hand even if the number of volunteering vehicles increases that would cause delay as the data traffic will be handled only from a base Station. One of the earliest studies done for air pollution monitoring was the School Bus Monitoring Study [31] conducted at University of California along with NRDC (National Resources Defense Council). The focus of this study was to analyze the health hazards posed to school children by their exposure to diesel pollutants. It also emphasized the urgent need for mobile monitoring of air quality because diesel exhaust is a known carcinogen and a cause of respiratory illnesses.

The Rutgers approach

Other approaches that we mentioned deal with pollution measurements that are performed using special units at fixed locations or dedicated or not mobile units. Since the air pollutants' measurements are rare and far in between, it can be considered as a **coarse-grained approach**. The Rutgers group [3] present a vehicular-based mobile approach for measuring fine-grained (more often in between and many measurements) air pollution in real-time. They propose two cost effective data collecting models – one that can be implemented on public transportation and the second that can be used as a personal sensing device. The problems with this approach are similar to the ones mentioned in San Diego's, California case, as when the air pollution unit is incorporated with a personal device it exists the risk of having false results as it's impossible to avoid the user's interference data with the air pollutants data. The problem with the first solution is the low number of network nodes. The public transportations units are more dedicated than the volunteering nodes but still it won't be enough coverage due to the limited number of bus lines. There are still zones where the public transportation is missing and having the same itinerary all the time will cause missing data form many spots in the whole area. In general from what we analyzed, we notice that the strategies used are related in general with high battery usage, high latency during the data transmission and high network load.

Wireless Ad-Hoc Networks

A wireless ad-hoc network is the network created without any fixed infrastructure, but it is a dynamic network with moving nodes. This technology started to get spreaded at the beginning of years 1970 with DARPA, PRNet and SURAN projects.

Later these architectures started to be used for new applications even in the civil environment. These new applications are related with new aspects of this technology like multicasting and security. These new aspects and are considered in our protocol. In this work we will consider the geographical routing too, by having the use of the GPS service provided from the satellite system.

Ad-hoc wireless sensors' network

Sensors are small units that can be used for different purposes. Those units can be used to measure temperature, humidity, density of gases or for many other purposes. Today's technological development made it possible to have sensors used everywhere and for innumerable purposes. We have heard of sensors used for weather forecast, smart homes, smart cars and also for biosensors used to sense and cure different diseases inside humans' body. But their power is multiplied when those sensors are used to work in groups forming in this way the networks' nodes. This network can be a fix or mobile one, wireless or ad-hoc. In the wireless ad-hoc sensors' network the sensors are distributed and their communication is not supported by from any infrastructure.

AirNetComm Protocol

In order to collect frequent data from as many spots as possible we have worked on designing a new virtual infrastructure hierarchical approach that uses the network created from vehicles moving and forming this way the nodes of an ad-hoc wireless network. If we know the time and location of critical conditions which means air polluted over a certain threshold, we can transmit the air status data to the traffic control offices and they can reconfigure the traffic distribution using time scheduling for different city zones or finding new ways for increasing the public transportation especially in critical areas.

From the point of view of information communication, our approach is based in our previous work on inter-vehicle communication protocols adapted and developed for air pollution sensors communications. The high traffic area is divided in virtual clusters, which move as the nodes move. For each cluster only one node at the time will be responsible for collecting the data from all other nodes positioned in the range of 100m (depends from the current wireless protocol used) and this is named Cluster Center.

We propose a virtual infrastructure created from the vehicles where the sensing unit will be installed. In order to have a low cost approach the communication scheme will be a hierarchical one using three levels of hierarchy: first, a simple sensing unit that transmits to the sensing neighbor with a higher rank of hierarchy, second: a sensing unit that has a certain number of neighbors (less than M), is located somewhere in the center of the cluster, third: a sensing unit that has a number of neighbors $>M$ and is found near the center of the cluster and those will be named Traffic Clusters.

AirCommNet Algorithm

According to this algorithm, the three levels of hierarchy Cluster Centers move together with most of their nodes (Fig.1 and Fig.2). Therefore, a flexible Virtual Infrastructure is created and maintained to enable scalable and effective communications. In each cluster we select one Cluster Centers (CC).

The hierarchical distribution of cluster Centers will be transferred to the hierarchy of their costs and to the traffic distribution.

One of Environment Protection companies can distribute several cars in that area and can patrol certain areas of the city. Those will represent the Cluster Centers for all the possible clusters.

The Hierarchical structure enables the optimization of the routing process. Each Cluster has a center, which is self-chosen (the EP cars) is located approximately in the geographical center of the cell.


If this is missing, then the cell members choose a center that will behave for a certain time interval as a Base Station. Every node has its geographical position given by Global Positioning System (GPS). At a certain rate each node updates the data from the GPS, which gives the Coordinates (x,y) for each node at a certain moment.

Then the higher ranked nodes transmit the data along to each-other, from Second Hierarchy cluster_Centers to First Hierarchy ones, using them as intermediate communication points and finally transmit the data to the gateway ->Internet-IMS (Information Management System). This can be a data center connected to the traffic controlling centers.

After analyzing the data the data center (IMS) decides about the traffic distribution modifications in real-time.

For this model, we will use a packed Air Sensors Box (ASB) that includes a microcontroller board with add-on sensors, a peripheral GPS receiver and a cellular modem. This box can be connected to the bus battery or a solar panel can be added to provide the needed power. The protocol to be used inside the clusters is ZigBee, but inside the second and first rank hierarchi clusters is IEEE80.11. ZigBee provides higher security but IEEE802.11 supports higher range of communications. On the other hand this combination saves the power consumption.

FIG 1: SENSOR WIRELESS NETWORK ALONG THE HIGHWAY



AirNetComm Benefits

The fact of using hierarchical communication scheme brings several benefits:

low cost for the hardware. Only the Cluster centers need to have more complex design, memory and transmission power.


This protocol ensures a lower network load, since there are fewer communications determined from the hierarchical scheme (Fig.2) : Only Cluster Centers communicate with Cluster Members in a local communication, in the second range of communication there are Few Second rank centers that communicate with the First Rank Centers and the high rank communications will be even fewer First Rank Centers (Tcenter), That communicate with the Base Station.

There is lower consumed power as the inside cluster communications are short Range communications. On the other hand this is related to the lowered latency especially for the inside cluster communications added with a lowered latency for the second and first rank of communications due to the lack of traffic. Fewer second and first rank centers are contributing to a much lowered traffic than all nodes communicating with the Base Station.

Due to the hierarchy much more sampling points can be added for each cluster ensuring a higher scalability, collecting data from more locations, and updating the data with a higher frequency.

As a conclusion we can say that this protocol contributes for a fine grained collecting data scheme which will help to have a clearer and detailed view of air pollution situation almost in real time.

FIGURE 2: MULTI-LEVEL HIERARCHICAL AD HOC SENSORS NETWORK



Conclusions and Future Work

As a conclusion we can say that this protocol contributes for a fine grained collecting data scheme which will help to have a clearer and detailed view of air pollution situation almost in real time. From the practical point of view the sensors box can include different kind of sensors depending from the pollutants. The most common are considered CO, NO₂ and SO₂, but other sensors will be used if another threat pollutant is disturbing for a certain area.

References

- http://www.jacobsschool.ucsd.edu/news/news_releases/release.sfe?id=1295
- R. Al-Ali, *Member, IEEE*, Imran Zuolkernan, and Fadi Aloul, "Air Pollution Monitoring", *IEEE Sensors Journal*, Vol.10, October 2010
- Srinivas Devarakonda, Parveen Sevusu, Hongzhang Liu, Ruilin Liu, Liviu Iftode, Badri Nath, Real-time Air Quality Monitoring Through Mobile Sensing in Metropolitan Areas, On Urban Computing, Chicago, USA, August 2013, International Workshop
- Yu Zheng, et al. U-Air: When Urban Air Quality Inference Meets Big Data. 19th KDD 2013.
- Clean Air Act Retrieved May 2013 from <http://www.epa.gov/air/caa/>
- Automobile Emissions-An Overview Retrieved May 2013 from <http://www.epa.gov/otaq/consumer/05-autos.pdf>
- AirData web portal Retrieved May 2013 from <http://www.epa.gov/airdata/>
- Effects of Ambient Air Pollution on Symptoms of Asthma in Seattle-Area Children Enrolled in the CAMP Study Retrieved May 2013 from <http://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC1240204/pdf/> (2013) Main page - Variable Technologies (Online) available at <http://nodesensors.com>
- Karl Aberer, Saket Sathe, Dipanjan Chakraborty, Alcherio Martinoli, Guillermo Barrenetxea, Boi Faltings, and Lothar Thiele. 2010. OpenSense: open community driven sensing of environment. In Proceedings of the ACM SIGSPATIAL International Workshop on GeoStreaming (IWGS '10), Mohamed Ali, Erik Hoel, and Cyrus Shahabi (Eds.). ACM, New York, NY, USA, 39-42. DOI=<http://doi.acm.org/10.1145/1878500.1878509>
- AIR: Area's Immediate Reading (September 2006) Retrieved May 2013 from <http://www.pm-air.net>
- Al-Ali, A. R.; Zuolkernan, I.; Aloul, F., "A Mobile GPRS Sensors Array for Air Pollution Monitoring," *Sensors Journal, IEEE*, vol.10, no.10, pp.1666, 1671, Oct. 2010. DOI=<http://dx.doi.org/10.1109/JSEN.2010.2045890>
- Budde, M.; Berning, M.; Busse, M.; Miyaki, T.; Beigl, M., "The TECO Envboard: A mobile sensor platform for accurate urban sensing — And more," *Networked Sensing Systems (INSS), 2012 Ninth International Conference on*, vol., no., pp.1, 2, 11-14 June 2012. DOI= <http://dx.doi.org/10.1109/INSS.2012.62405> (2013) N-Smarts available at <http://www.paulos.net/papers/2008/NSDR08.pdf>
- S. Choi, N. Kim, H. Cha, and R. Ha. Micro sensor node for air pollutant monitoring: Hardware and software issues.

- MEMS, 2009. DOI=www.mdpi.com/1424-8220/9/10/7970/pdf
- Wan-Young Chung, Sung-Ju Oh, Remote monitoring system with wireless sensors module for room environment, *Sensors and Actuators B: Chemical*, Volume 113, Issue 1, 17 January 2006, Pages 64-70, ISSN 0925-4005, 10.1016/j.snb.2005.02.023.
- Prakash Doraiswamy, Wayne T. Davis, Terry L. Miller, Joshua S. Fu and Yun-Fat Lam. 2005. *Measuring Air Pollution Inside And Outside of Diesel Truck Cabs*. Report prepared for US EPA by University of Tennessee, Knoxville,
- Tsow, F.; Forzani, E.; Rai, A.; Rui Wang; Tsui, R.; Mastroianni, S.; Knobbe, C.; Gandolfi, A.J.; Tao, N.J., "A Wearable and Wireless Sensor System for Real-Time Monitoring of Toxic Environmental Volatile Organic Compounds," *Sensors Journal*, IEEE, vol.9, no.12,
- Richard Honicky, Eric A. Brewer, Eric Paulos, and Richard White. 2008. N-smarts: networked suite of mobile atmospheric real-time sensors. In *Proceedings of the second ACM SIGCOMM workshop on Networked systems for developing regions (NSDR '08)*. ACM, New York, NY, USA, 25-30. DOI=<http://doi.acm.org/10.1145/1397705.1397713>
- A. Joki, J. Burke, and D. Estrin. Campaignr-a framework for participatory data collection on mobile phones. Technical report, CENS, UCLA, 2007
- Shilton, K., Burke J., Estrin D., Hansen M., Gorvindan R., and Kang J. 2009. Designing the Personal Data Stream: Enabling Participatory Privacy in Mobile Personal Sensing. The 37th Research Conference on Communication, Information and Internet Policy (TPRC). DOI=<http://escholarship.org/uc/item/4sn741ns>
- Predrag Klasnja, Sunny Consolvo, Tanzeem Choudhury, Richard Beckwith, and Jeffrey Hightower. 2009. Exploring Privacy Concerns about Personal Sensing. In *Proceedings of the 7th International Conference on Pervasive Computing (Pervasive '09)*. DOI=http://dx.doi.org/10.1007/978-3-642-01516-8_13
- Gianfranco Manes, Giovanni Collodi, Rosanna Fusco, Leonardo Gelpi, and Antonio Manes. 2012. A Wireless Sensor Network for Precise Volatile Organic Compound Monitoring. *International Journal of Distributed Sensor Networks* Volume 2012, Article ID 820716, 13 pages DOI=10.1155/2012/820716
- Gina M. Solomon, Todd R. Campbell, Gail Ruderman Feuer, Julie Masters, Artineh Samkian, Kavita Ann Paul. 2001. *NO BREATHING IN THE AISLES, Diesel Exhaust Inside School Buses*. Report prepared by the Natural Resources Defense Council and Coalition for Clean Air. <http://www.nrdc.org/air/transportation/schoolbus/schoolbus.pdf>
- Yu Zheng, et al. U-Air: When Urban Air Quality Inference Meets Big Data. 19th KDD 2013.
- Air Quality Egg – <http://airqualityegg.com>

DISTRIBUTED WIRELESS SENSOR NETWORKS FOR SAVING THE FAUNA IN LAKES

MIMOZA DURRËSI

mimoza.durresi@uet.edu.al

ABSTRACT

The fauna in lakes is threatened because of the water pollution created by humans. The high use of pesticides and the toxins created from the industrial wastes, create very challenging lives for the animal that live in the lakes and as a result intoxicating our food too. Before testing the fish for heavy metals, before testing the plants growing in the nearby areas is critical to test the water quality in order to respect some thresholds. In this paper we propose the creation of wireless distributed sensors networks that would consist on distribution heavy metal detection sensors in several 3D groups and making them patrol the lake space. One of the sensors of each group would collect the data in an optimal frequency serving as first tier of the hierarchical infrastructure. Depending from the lake surface the next communication step toward the Gateway and the Base station would be direct or indirect. Having updated information for water quality transmitted to management centers would give us the idea for the fauna quality, too. If the indicators are above some certain threshold, those animals are not to be considered as food, the fauna must be evacuated and the water pollutant factors should be investigated.

Keywords: *Wireless Sensor Networks (WSN), ad-hoc networks, Metal Detector Sensor, Pollution control board*

Introduction

The natural resources are becoming more polluted every day. The water cycle makes the pesticides, chemical and harmful wastes, industrial wastes especially the hydrocarbon mixed together and increasing the risk for contaminating our food, air and drinking water resources. In higher risk are the lake waters for two main reasons: first because these waters are still and second these waters aren't salted and iodinated as the sea waters are. For this reason the need for monitoring their pollution conditions is more critical. In reality the monitoring of lake waters is done mostly in the surface, taking samples of water and analyzing them in laboratory. This can be considered as gross grain monitoring. On the other hand it is important to have a fine grained monitoring, which means to monitor the water all the time (the water samples to be considered more often) and from more points in the lake. This is obvious as the water quality is very changeable in terms of the location and the depth.

Wireless Sensor Networks and their applications

The technology development in general and the information technology especially brought many applications that are helping in monitoring of the water lakes pollution. One such way is the collection of information collected from distributed sensors in lakes' surfaces. The distributed sensors forms this way the Wireless sensors Networks (WSN). This field started a very successful development in the year 2000 and brought so many successful applications in forests, waterways, buildings, security, and the battlefield, and even in bioengineering.

The WSN is used in conjunction with the other parts of the system that are: the internet links from the WSN to a server, databases, and web presentation tools. Very often the Internet is not available, especially in the rural areas. And that's the reason why each of the components is important for the application. The different kind of applications all have in common the presence of the distributed wireless sensors situated in the study area, collection of the needed information and sending it in the respective servers for further data analysis. Each application presents different challenges which such as mobility, actuation, energy, and continuous and good quality connectivity. In this work we propose a design for wireless sensor lakes water monitoring (L-WASNET) that contributes in providing the abovementioned qualities and serves for monitoring the lake waters which means monitoring our food.

WSN for Lake Water Monitoring

In [2] the group of researchers participated in a project that intended to measure vertical temperature profile at many points on a large water storage that provides most of the drinking water for the city of Brisbane, Australia. The data collected from an interval of temperature transducers at depths from 1 to 6 m, gives information about water mixing within the lake which can be used to predict the development of algal blooms. There are several challenges such as: 1) Low-power wireless communications over water can create the multipathing (radio waves reflected from the water surface destructively interfere with waves traveling directly) and the Antennas position especially in windy weather. A robotic boat is used to patrol the lake waters in case of emergency. Interfacing this robotic boat to the static sensor nodes is difficult and challenging.. 2) Technology: The network comprises floating sensor nodes which contain the now standard platform of a Fleck-3, FOS, and a custom expansion board. To save the energy a solar panel has been used, along with a solar cell. A GPS is also used to accomplish the recording of the sensor locations (given in coordinates) together with the rest of the data such as pollution information. This architecture gives the possibility to obtain high-rate measurements along large area.

According to this solution we will have a few data gathered from a certain lake area, which means will have coarse grained data. If we increase the number of monitoring boats the data will be more fine grained but the cost will be much higher and the lake surface might not be available especially during the day. For this reason we thought of a different solution that would provide fine grained collected data with a much lower cost.


Lake Water Sensor Networks Protocol

Lake Water Sensor Networks Protocol (L-WASNET) is designed by distributing a group of sensors and actuators that are interconnected by wireless sensor networks. Sensors gather information about the state of the lake waters in a certain moment of time. Actuators react to this information by performing appropriate actions. That way the L-WASNET enables a cyber system to monitor and control the state of the lake waters. According to this protocol every actuator is connected to a group of sensors and the integrity of those groups of actuator-sensors patrol the lakes waters at all the time. The actuators serve now as Group Center that will collect the data from all the sensors of its group. Actuators communicate with each other so the information will be transmitted from one Group Center to the other sequentially till reaching the Gateway and the Base Station in the case of the lack of coverage being too far from Base Station.

If the sensors are not physically connected with the actuators, then the number needed to cover the whole lake area might be too big, giving a higher cost. We propose a system where the sensors are connected to actuators and move together as a

whole system. In terms of wireless communications we can use a hybrid scheme that means that the sensors with the actuators will follow the ZigBee protocol and the actuators between them and with the Gateway will follow the IEEE 802.11 Protocol. The data collected will be sampled periodically and transmitted to the data Server. This can have a web Interface for better Information Management.


FIG 1: LAKE'S AREA COVERED WITH DISTRIBUTED SENSORS AND ACTUATORS



The system patrols the lake water interminently, the data will be transmitted from the whole surface and even in a certain depth depending from the nature of water and from the kind of fauna living in the specific area. This system can be used in fish farms as the fish condition and quality is very important. The main processes to be performed are:

1)Monitoring: The basic factors of online water tone monitoring, sampling and analysis, almost in real time until an anomaly or deviation from the baseline or base state is noticed. 2) Event detection and potential decision: Event detective work is the process or mechanism by which an anomaly or deviation from the baseline or base state is noticed. 3) IMS (Information Management System) decisions: Procedures to be performed using information from all contamination warning system groups in order to stop fishing for some time from that area. For this model, we propose a packed Lakes Pollutants Sensing Box (LPSB) that includes A) a microcontroller board with add-on sensors, B) a peripheral GPS receiver C) and a cellular modem. The unit will be connected to a battery or a solar panel that would provide the power supply needed to operate. The most critical pollutants are the nitrites, bacteria, especially e-coli and heavy metals especially mercury. The sensors module will be constructed from our collaborators in other universities. The system can be connected with the clients that are Clients and they need to have real time quality information.

FIG 2: INFORMATION MANAGEMENT SYSTEM



Conclusions

This system represents a virtual hierarchical infrastructure that helps for monitoring the lakes' area from different pollutants especially heavy metals that are so dangerous for the fauna growing there and for the human. The information collected represents a fine grained scheme data that can be reached with lower cost, high quality and from a information management center giving the possibility for decision taking at the very moment that the toxicity threshold will be reached.

References

- Gokulram.K, Dhakshinamoorthy.T, Intelligent Pollution Monitoring Using Wireless Sensor Networks, IJRET: International Journal of Research in Engineering and Technology eISSN: 2319-1163 | pISSN: 2321-7308
- Corke, P., Wark,T., Jurdak, R., Hu, W., Moore, D., Environmental Wireless Sensor Networks, Proceedings of the IEEE | Vol. 98, No. 11, November 2010
- Xia. F., QoS Challenges and Opportunities in Wireless Sensor/Actuator Networks, Sensors 2008, 8(2), 1099-1110, www.mdpi.org/sensors.
- Mimoza Durrresi, Vamsi Paruchuri, Arjan Durrresi, Leonard Barolli, Makoto Takizawa:
A scalable anonymous protocol for heterogeneous wireless ad hoc networks. J. Embedded Computing 3(1): 77-85 (2009) Mimoza Durrësi, Arjan Durrësi, Leonard Barolli:Sensor Inter-Vehicle Communication for Safer Highways. AINA 2005: 599-604 Juan V. Capella, Alberto Bonastrea, Rafael Ors, Miguel Peris A step forward in the in-line river monitoring of nitrate by means of a wireless sensor network
- Ra'ul S'aez, Salvador Climent, Ricardo Mercado, Angel Perles, Pedro Yuste, ` Juan Vicente Capella, Sara Blanc, Vicente Busquets, Juan Jos'e Serrano, and Rafa Ors, Modeling and Simulation of Underwater Wireless Sensor Networks Underwater communication
- Gina M. Solomon, Todd R. Campbell, Gail Ruderman Feuer, Julie Masters, Artineh Samkian, Kavita Ann Paul. 2001. *NO BREATHING IN THE AISLES, Diesel Exhaust Inside School Buses*. Report prepared by the Natural Resources Defense Council and Coalition for Clean Air.
<http://www.nrdc.org/air/transportation/schoolbus/schoolbus.p>
- M.Durrësi, A.Durrresi, L.Barolli, Hierarchical Communications for Battlefields, Journal of IEEE Computer Society.
- N. Alon, A. Bar-Noy, N. Linial, and D. Peleg. A lower bound for radio broadcast. *J. Comput. Syst. Sci.*, 43:290–298, October 1991.

NDIKIMI I SISTEMEVE TË INFORMACIONIT NË SIPËRMARRJE

IDAVER SHERIFI

Universiteti Epoka, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe
Administrative, Departamenti i Administrim Biznesit

ABSTRAKT

Sipërmarrësi është një person i cili duke përdorur iniciativën nis një sipërmarrje të re me qëllim fitimin, duke marrë përsipër rreziqet dhe përgjegjësitë që e shoqërojnë atë. Në anën tjetër, interneti është revolucioni më i madh në shkencë dhe teknologji i kohës tonë. Me përhapjen e përdorimit të internetit si dhe të sistemeve të informacionit si mjet, çdo ditë e më shumë shtohet numri i sipërmarrësve të cilët kanë marrë risk dhe nisur iniciativa biznesi në internet, duke i shtuar literaturës edhe një term të ri, atë të E-sipërmarrësit.

Ky artikull synon që duke shqyrtuar literaturën mbi termat bazë të kësaj fushe, të analizojë ndikimin që sistemet e informacionit kanë në sipërmarrje dhe shfaqjen e një kategorie të re sipërmarrësish, që tashmë quhen e-sipërmarrës. Përveç fenomenit botëror, në artikull do të analizohen gjithashtu edhe rastet e ngjashme në ekonominë shqiptare.

Fjalë kyç: *sistemet e informacionit, sipërmarrja, interneti, e-sipërmarrja*

1. Hyrje

Sipërmarrja është një temë shumë e popullarizuar mes akademikëve dhe kërkuesve në fushën e menaxhimit. Janë shkruar libra dhe artikuj shkencor të shumtë në këtë fushë ndërsa shumë qeveri ofrojnë programe të ndryshme për zhvillimin e sipërmarrjes, pasi sipërmarrja shihet si çelës i zhvillimit dhe rritjes ekonomike. Ndërkohë me zhvillimin e teknologjisë, biznesi fillon me përdorimin në funksion të saj të teknologjive të informacionit, të cilat për shumë individ dhe biznese ndihmojnë në funksionimin më efektiv të biznesit ndërsa nuk janë të pakta edhe rastet ku sistemet e informacionit të bazuara në teknologji të jenë vet inovacioni dhe të shërbejnë për ngritjen e bizneseve të reja të bazuara në internet dhe të krijojnë kategorinë e re të sipërmarrësve të quajtur e-sipërmarrës. Kjo kategori e re e dal si rezultat i shpirtit sipërmarrës dhe kombinimit të saj me mundësitë që të japin sistemet e informacionit, është lloji i sipërmarrësve të cilët çdo ditë e më shumë po zënë vend në tregun global.

2. Sipërmarrja

Fjala sipërmarrës, në përdorimin ndërkombëtar “entrepreneur” rrjedh nga fjala frënge “Entreprendre”, e cila është përdorur për të përshkruar personin që organizonte një event muzikor apo ngjarje tjera argëtuese. Më vonë, në shekullin e XVI-të, kjo fjalë është përdorur për komandantët e ushtrive ndërsa në shekullin e XVII-të, kuptimi i fjalës është zgjeruar edhe për aktivitete të fushës së inxhinierisë së ndërtimit. (Havinal, 2009)

Për herë të parë, këtë fjalë në funksion të aktiviteteve ekonomike e ka përdorur irlandezi që jetonte në Paris, Richard Cantillon, në veprën “Essai sur la nature du commerce en general” të publikuar në vitin 1755, ku ai thotë se sipërmarrësi është një bartës i riskut, i pasiguruar. (Brewer, 1992)

Cantillon e definonte sipërmarrësin si një person i cili paguan një çmim të caktuar për një produkt dhe e rishet atë me një çmim të pacaktuar, në këtë mënyrë duke vendosur për marrjen dhe përdorimin e burimeve dhe si pasojë duke pranuar edhe riskun e sipërmarrjes. Si fjalë, për here të parë shihet në fjalorin e gjuhës frënge, “Dictionnaire Universel de Commerce” i përgatitur nga Jacques des Bruslons, i publikuar në vitin 1723. (Navale, 2013)

Joseph A Schumpeter, i ka cilësuar si “inovatorë” sipërmarrësit, duke e konsideruar zhvillimin ekonomik si një dinamikë ndryshimi të sjellë nga sipërmarrësit përmes krijimit të kombinimeve të reja të faktorëve të prodhimit, që ndryshe quhet inovacion. (Havinal, 2009)

Jean-Baptiste Say e ka vendosur “sipërmarrësin në thelbin e gjithë procesit të prodhimit dhe shpërndarjes” duke e portretizuar atë më shumë si menaxher i cili kthehet në agjent të prodhimit në një ekonomi, sesa marrës risku. (Hebert Link, 2009) Ai e definon sipërmarrësin si “person që ndërmer një iniciativë, në veçanti një kontraktues, i cili vepron si ndërmjetës midis kapitalit dhe forcës punëtore” (Anchorena & Ronconi, 2013)

Ndërkohë, E. E. Hagenka shkruar se “Sipërmarrësi është një njeri i ekonomisë i cili tenton të maksimizojë fitimet e tij përmes inovacionit, përfshin zgjidhjen e problemeve dhe merr satisfaksion nga përdorimi i aftësive në përballimin e problemeve” (Sharma, 2008)

Michael Porter e konsideron sipërmarrjen si jetike për ekonominë kombëtare duke thënë se ajo është “në zemrën e avantazhit kombëtar” (Porter, 1990).

Joseph A. Schumpeter (1965) i përcakton sipërmarrësit si “individë të cilët shfrytëzojnë mundësitë e tregut përmes risive teknike dhe/ose organizative”. Ai e sheh sipërmarrjen nga perspektiva ekonomike duke u fokusuar në perceptimin e mundësive të reja ekonomike dhe futjen e mëvonshme e ideve të reja në treg.

“Sipërmarrja është një mënyrë e menaxhimit e cila përfshin ndjekjen e mundësive pa i marrë në konsideratë burimet që aktualisht kontrollohen. Sipërmarrësit identifikojnë mundësitë, mbledhin burimet e nevojshme, implementojnë një plan aksionesh praktike dhe marrin shpërbllimin në një mënyrë fleksible në kohë (Sahlman et al., 1996).

Në 25 vitet e fundit është shtuar dukshëm numri i studimeve të cilat analizojnë përcaktuesit e sipërmarrjes. Holmes dhe Schmitz (1990) janë fokusuar në anën teorike në punimin e tyre me titull “A theory of entrepreneurship and its application to the study of business transfers”, ndërsa Evans dhe Leighton (1989) kanë publikuar studimin e tyre mbi anën empirike të sipërmarrjes me artikullin “Some empirical aspects of entrepreneurship”.

3. Sistemet e Informacionit

Sipas Whitten (2001), Sistemi i Informacionit është një marrëveshje mes njeriut, të dhënave, proceseve dhe ndërfaqes, që ndërveprojnë për të mbështetur operacionet e përditshme në një biznes si dhe mbështetje për të zgjidhur problemet dhe nevojat për vendimmarrje të menaxherëve dhe përdoruesve. Me fjalë të tjera, sistemi i informacionit mund të përshkruhet edhe si tërësi e të gjithë mjeteve dhe metodave të cilat u ofrojnë menaxherëve informacione për të mbështetur operacionet dhe vendimmarrjen në një organizatë.

Laudon dhe Laudon i kanë definuar sistemet e informacioneve si një grup komponentësh të ndarë të cilët mbledhin, përpunojnë, ruajnë dhe shpërndajnë informacionet për të mbështetur vendimmarrjen, koordinimin dhe kontrollin në një organizatë. Sistemet e informacioneve përmbajnë informacione për njerëz, vende dhe gjëra të rëndësishme brenda organizatës

ose në mjedisin ku operon. Me informacion nënkuptohen të dhënat të cilat janë formësuar në një formë që ka kuptim dhe është e përdorshme nga njeriu. (Laudon & Laudon, 2012)

Sistemet e Informacionit mbështesin operacione efçente biznesi, punën në grup dhe bashkëpunimin në ndërmarrje, ose vendimmarrjen efektive në biznes. Kështu, teknologjia e informacionit mund të ndryshojë mënyrë si konkurron biznesi. (O'Brien & Marakas 2006, 40).

Një nga rolet kryesore të aplikacioneve të sistemeve të informacionit në biznes është të ofrojë mbështetje efektive në strategjinë e kompanisë duke përdorur IT-në për të zhvilluar produktet, shërbimet dhe kapacitetet që i japin kompanisë avantazh të madh mbi konkurrentët me të cilët përballet në tregun global. Sistemet strategjike të informacionit mbështesin ose me fjalë të tjera formësojnë pozicionin konkurrues dhe strategjitë e një sipërmarrjeje. Kështu, sisteme strategjike informacioni mund të jetë çdo lloj sistemi informacioni (TPS, MIS, DSS, etj.) që përdor teknologjinë të ndihmojë një organizatë të fitojë avantazh konkurrues, të zvogëlojë disavantazhin konkurrues ose të përmbushë objektivat e tjera strategjike të ndërmarrjes. (O'Brien & Marakas 2006, 40, 42)

3.1.Ndikimi i Sistemeve të Informacionit në Sipërmarrje

Janë të shumta studimet të cilat janë fokusuar në sistemet e informacionit dhe të teknologjisë, duke analizuar ndikimin që këto këto sisteme kanë në sipërmarrjen dhe duke gjetur shumë faktorë që në një mënyrë kanë lidhje me sipërmarrjen.

Sipërmarrësit kombinojnë disa tipare të personalitetit - inovacionin, marrjen e riskut, proaktivitetin në sensin e bërjes së gjërave që duhen bërë për të realizuar kombinimin e ideve me marrjen e përgjegjësisë për suksesin apo dështimin (Covin & Slavín, 1991; Morris & Sexton, 1996).

Sistemet e IT ndikojnë në produktet dhe shërbimet, tregjet, koston e prodhimit dhe diferencimin e produktit të firmës. Kështu që, sukcesi i kompanive të suksesshme varet në masë të madhe nga implementimi dhe përdorimi kreativ i Teknologjive të Informacionit. (Deans & Kane, 1992)

Pearse J. M. et al. (2008) i përshkruajnë teknologjitë e informacionit në një linjë me sipërmarrjen sociale si leva financiare për zhvillim të qëndrueshëm.

Kompjuterat dhe teknologjitë e tjera kanë gjetur vend në të gjitha fushat e biznesit, industrisë, bankut, arsimit dhe qeverisjes ndërsa Deans dhe Kane (1992) kanë gjetur se teknologjia e informacionit luan një rol të padiskutueshëm në suksesin e një kompanie në kushte ekonomike të pasigurta dhe të turbullta.

Në përfundim, mund të thuhet se sipërmarrja është procesi krijimit të vlerës duke kombinuar një përzierje unike të koncepteve të lartpërmendura, në mënyrë që të përfitojnë nga një mundësi. (Morris & Sexton, 1996)

Ndërkohë, në vende të ndryshme janë bërë studime për relacionin mes sistemeve të informacionit dhe atyre teknologjike dhe sipërmarrjes, ku vlen të përmendet studimi i Janson dhe Wrycza i bërë në Poloni, të cilët kanë gjetur një marrëdhënie pozitive me nivel të lartë mes përdorimit të IT dhe sipërmarrjes në këtë vend.

4. E-Sipërmarrja

Futja e teknologjisë në jetën e njeriut dhe përhapja masive e përdorimit të internetit, kanë ndikuar dukshëm edhe në mënyrën se si bëhet biznes. Teknologjitë e reja, produkt i së cilës janë sistemet e informacionit, kanë frymëzuar shumë njerëz që të kërkojnë forma të reja të bërjes biznes, duke kaluar nga sipërmarrja klasike në atë që zhvillohet në internet. Këto lloj nismash, që përbëjnë inovacione të rëndësishme që lehtësojnë jetën e njeriut dhe ofrojnë shërbime të reja në forma krejtësisht inovative, nxjerrin në skenë një lloj tjetër biznesmenësh, atë të e-sipërmarrësve.

Termi “e-sipërmarrje” përshkruan aktin e themelimit të një kompanie specifikisht në ekonominë e internetit (net economy). (Matlay, 2004)

Bazat e ekonomisë së internetit janë ndërtuar mbi katër risitë teknologjike: telekomunikacioni, teknologjitë e informacionit, teknologjia mediatike dhe ajo argëtuese (që ndryshe quhen tregu TIME). Këto risi kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë dukshëm mënyrat e mundshme në të cilat menaxhohen informacioni, komunikimi dhe transaksionet. (Kollmann, 2001)

Kështu, informacioni bëhet një faktor i pavarur i prodhimit (Porter & Millar, 1985; Weiber & Kollmann, 1998) dhe krijon ekonominë e informacionit.


Rritja e mbështetjes së proceseve të biznesit që përdorin sisteme elektronike luan rol kryesor në këtë fazë. Janë një numër kushtesh për këtë që duhen identifikuar (psh. e-biznesi, e-commerce, informatika ekonomike, ekonomia e networkut), të cilat deri në një shkallë mund të përdoren si sinonime të njëri tjetrit. (Jelassi & Enders, 2005)

Që nga fillimi i viteve '90-të, teknologjia inovative e informacionit ka detyruar ndryshime, një ndryshim strukturor në sferën sociale dhe atë ekonomike përmes digjitalizimit të informacionit dhe të rrjeteve kompjuterike (Hagel & Singer, 1997; Tapscott, 1996). Kështu, shumë shpejt, kompjuterat nga mjete për profesionistë, përmes internetit, smarphonëve dhe televizioneve smart janë kthyer tashmë në pjesë të përditshmërisë së pjesës më të madhe të popullsisë.

Për ta definuar këtë lloj ekonomie, mund të thuhet se “ekonomia e internetit i referohet përdorimit komercial të rrjeteve elektronike të të dhënave (electronic data networks), e quajtur ndryshe një ekonomi e rrjetit digjital, e cila përmes platformave të ndryshme elektronike mundëson arritjen e rezultateve nga informacioni, komunikimi dhe proceset transaksionare”. (Kollmann, 2006)

Mënyra më e thjeshtë e strukturimit dhe qartësimit të termave, përcaktimit të kufijve dhe fushës së aplikimit është e mundur përmes Modelit Shell të ekonomisë së internetit, që mund të shihet në figurën numër 1.

FIGURA NR. 1: MODELI SHELL I EKONOMISË SË INTERNETIT




Burimi: Kollman (2006, fq. 324)

Me shfaqjen e ekonomisë së internetit, hapet një hapësirë e re për sipërmarrësit që të krijojnë mundësi për të fituar. Falë kësaj, sipërmarrësi mund të krijojë një vlerë konsumatore jo vetëm përmes aktivitete fizike, por edhe vlerave në ambient elektronik.

Zinxhiri i vlerës në ekonominë reale është i bazuar në qasjen e shkencëtarit të njohur Michael Porter (1985). Zinxhiri i vlerës e ndan kompaninë në aktivitete strategjiksht relevante dhe identifikon vlera të aktiviteteve fiziksht dhe teknologjiksht të ndryshme (shih figurën 2) për të cilat konsumatori është në gjendje të paguaj. Ndërkohë që, vlerat e aktiviteteve janë shtyllat themelore të strukturës nga të cilat kompania prodhon një “produkt të vlefshëm” në sytë e konsumatorit, dhe më pas ky produkt formon bazën mbi të cilët ngrihet një sipërmarrje në ekonominë reale. Në këtë model, informacioni mund të përdoret për analizim dhe monitorim më të mirë të procesit aktual. Është shumë e rëndësishme të theksohet se më parë, informacioni është përdorur si element mbështetës dhe jo si një “burim konsumatorësh dhe/ose vlerë korporate” i pavarur. (Kollmann, 2006)

Në anën tjetër, zinxhiri i vlerës në ekonominë e internetit është i bazuar në qasjen e Weiber dhe Kollmann (1998). Sipas kësaj qasje, përmes dimensionit të ri të informacionit, si një burim i pavarur i avantazhit kompetitiv, vlera mund të krijohet përmes aktiviteteve elektronike tregtare në rrjete të dhënash të ndara nga zinxhiri fizik i vlerave. Këto aktivitete me vlerë të shtuar elektronike nuk janë të krahasueshme me aktivitetet e zinxhirit që krijojnë vlera fizike të prezantuara nga Porteri (1985) por janë të karakterizuara për mënyrën se si përdoret informacioni. Aktivitetet e këtylla të vlerës mund të përfshijnë elementë si koleksionimi, sistematizimi, përzgjedhja, kompozimi dhe shpërndarja e informacionit (shih figurën nr. 2). Me fjalë të tjera, “zinxhiri i vlerës elektronike” manifestohet përmes këtyre aktiviteteve specifike të krijimit të vlerave brenda rrjeteve digjitale të të dhënave, që rrjedhin nga dhe kanë impakt vetëm në ekonominë e internetit. Si rezultat, idetë inovative të biznesit evoluojnë duke përdorur platforma të ndryshme dhe si pasojë nxjerrin produkte të reja elektronike dhe konsumatorët janë të interesuar për të paguar për një vlerë të krijuar nga ky produkt, i cili përbën edhe bazën mbi të cilin themelohet një kompani në ekonominë e internetit (figura 2).

FIGURA NR. 2: KONCEPTI I ZINXHIRIT TË VLERËS NË EKONOMINË E INTERNETIT



Burimi: Kollman (2006, fq. 327)

4.1 Themelimi i një sipërmarrjeje në ekonominë e internetit

Themelimi i një sipërmarrjeje në ekonominë e internetit në të shumtën e rasteve është unik në llojin e vet dhe nuk është vazhdimësi e një kompanie aktuale apo që kopjon një strukturë ekzistuese të një kompanie. Këto kompani shpeshherë vërehet të jenë kompani të themeluara nga individ të vetëpunësuar në firmat e regjistruara rishtazi. Gjithashtu vërehet se shumica e kompanive të themeluara në ekonominë e internetit janë inovative, pra jo imituese të kompanive ekzistuese.

Këto lloj kompanisë, të filluara si start-up-e, janë lloje biznesesh ku faktorët e themelimit fillestar të përmendura nga Schumpeter (1911) kombinohen në një formë të re. Ky kombinim i ri përfshin faktorë material dhe jomaterial. Rritja e rëndësisë së “informacionit” si një faktor i rëndësishëm në avantazhin konkurrues ka rritur pjesërisht edhe rëndësinë e faktorëve jo material (p.sh. njohuritë, etj). Për këtë arsye, firmat e reja që janë themeluar në ekonominë e internetit janë themeluar vazhdimisht të bazuara mbi njohuri të reja dhe faktorë kreativë konceptual, pra ndryshon mënyra si trajtohet dhe përpunohet informacioni në kontekstin e krijimit të vlerës elektronike për të formuar një produkt. (Kollmann, 2006)

Gjatë ndërtimit të zinxhirit të vlerës në ekonominë e internetit, është e domosdoshme të vendoset çfarë forme e vlerës elektronike po “krijohet” në sytë e konsumatorëve për të cilën ai do të jetë i gatshëm të paguaj, pra që ta bëjë ofertën online atraktive nga këndvështrimi i konsumatorit.

Procesi elektronik i krijimit të vlerës në ekonominë e internetit nuk është proces që duhet bërë vetëm njëherë por ai duhet të rishikohet në vazhdimësi. Ai është një proces i vazhdueshëm i përvetësimit, përpunimit dhe transferimit të informacionit sa herë që të ketë nevojë, e sidomos kur të dhënat nga të cilat krijohen informacionet ndryshohen shpesh. Kështu që, të dhënat duhet të kontrollohen vazhdimisht në mënyrë që të jenë të përditësuara. (Kollmann, 2006) Për ta pasqyruar konkretisht këtë proces elektronik të krijimit të vlerës në ekonominë e internetit, mund të shihet Figura 3, e ilustruar me disa shembuj konkret se si krijohet vlera në këtë fushë.

4.2 E-Sipërmarrja në Shqipëri

Rëndësia e sipërmarrjes në ekonomi është e njohur gjerësisht. Gjatë dy dekadave të kaluara, Shqipëria ka shënuar një rritje të madhe në numrin e sipërmarrësve, pas një periudhe rreth pesëmbëdhjetë vjeçare me një ekonomi të centralizuar shtetërore ku

FIGURA NR. 3: SHEMBUJ TË PROCESIT ELEKTRONIK QË MBËSHTET KRIJIMIN E VLERËS NË EKONOMINË E INTERNETIT

	Mbledhja e Informacionit	Përpunimi i Informacionit	Transferimi i Informacionit	Vlera e shtuar
google.com	Të dhëna rreth sajteve dhe kërkime (=input)	Përputhja e fjalëve të kërkimit me përmbajtjen e sajtit	Lista e sajteve sipas ngjashmërisë (=output)	Informacione Seleksionim
albeu.com	Lajme, informacione, foto, video (=input)	Klasifikim i informacioneve, renditje, analizim	Listimi i lajmeve, motit, statistikave reklamave (=output)	Informacione Seleksionim
123.al	Të dhëna rreth ofertave (=input)	Përputhje e kërkesës me ofertën	Ofertat e detajuar dhe mundësia për të blerë online (=output)	Informacione Seleksionim Transaksione
hotele.albeu.com	Të dhëna rreth hoteleve, rezervime online (=input)	Përputhje e kërkesës me ofertën (=input)	Ofertat e hoteleve të dhëna për hotelin (=output)	Informacione Seleksionim Transaksione

nuk lejohej sipërmarrja private. Kjo periudhë, shënon edhe periudhën me shfaqjen e numrit më të madh të sipërmarrësve dhe sipërmarrjeve të reja duke i hapur vendit mundësinë për rritje ekonomike.

Përveç sipërmarrjeve të zakonshme edhe në Shqipëri janë shfaqur viteve të fundit sipërmarrje të bazuara në internet, të filluara në të shumtën e rasteve si start-upe. Më të përhapurat janë ato të portaleve informative të internetit, të cilat ofrojnë shërbime lajmesh ndërsa të ardhurat kryesisht i sigurojnë nga reklamat në faqet e tyre në internet.

Të tilla janë faqet informative të mediave tradicionale si topchannel.tv, balkanweb.com, panorama.com.al, oranews.tv, rtlkive.com, koha.net, etj. apo edhe sipërmarrjet e pastërta të webit, të cilat nuk janë zgjatim i një lloji medie tjetër por janë themeluar në internet, siç janë portali Albeu.com i themeluar në vitin 2003, telegrafi.com, ikub.al, gazetastart.com, portalb.com, almakos.com, etj.

Këto sipërmarrje të cilat operojnë ekskluzivisht në internet, të gjithë aktivitetin e tyre tregtar e zhvillojnë përmes internetit, duke ofruar shërbime jo materiale. Sipërmarrjet e kësaj kategorie, u ofrojnë konsumatorëve (në këtë rast lexuesve) informacione të ndryshme, për të cilat ka kërkesë nga audienca. Por, ky shërbim i ofruar nuk ju faturohet lexuesve siç është në rastin e gazetave të cilat blihen me lekë. Këto sipërmarrje, informacionin e ofrojnë pa pagesë ndërsa të ardhurat i sigurojnë nga palët e treta, që janë reklamuesit.

Nga intervistat që janë realizuar me aktorë të tregut (portalet dhe agjencitë e marketingut), mësojmë se tregu i përgjithshëm i reklamave në Shqipëri që është financuesi kryesor i këtyre sipërmarrjeve kap vlerën e 32-34 milionë euro për vitin 2014, ndërsa këtë vit (2015) pritet një rënie e lehtë si rezultat i uljes së buxheteve të reklamave nga kompanitë. Nga kjo shumë, sipërmarrjet e internetit në tregun mediatik, që janë edhe pjesë e studimit tonë, në vitin 2014 kanë arritur të tërheqin pak mbi 1 milion euro të buxhetit total të reklamave të shpenzuar në Shqipëri, ndërsa për vitin 2015 pritet një rritje në shumën totale që këto sipërmarrje do të përfitojnë, pavarësisht rënies së buxheteve totale të reklamave, që do të thotë se këto sipërmarrje të reja janë duke fituar terren ndaj sipërmarrjeve tradicionale në tregun mediatik.

Një tjetër lloj sipërmarrjesh që funksionojnë në internet janë edhe ato të e-commerce (shitblerjeve) në internet. Tashmë në Shqipëri janë disa sipërmarrje të cilat së bashku realizojnë të ardhura mujore deri në disa qindra mijëra euro. Në këtë kategori sipërmarrjesh, vërehet një nën klasifikim, si faqe që shesin produkte të ndryshme në formën e dyqaneve virtuale dhe faqe që shesin produkte dhe shërbime të bazuara në paketa ofertash (shitje me kupon).

Në grupin e parë të sipërmarrjeve e-commerce, ndër më të njohurat janë gripi.al dhe ebuy.al në Shqipëri dhe smard.info në Kosovë ndërsa në grupin e sipërmarrjeve e-commerce që bëjnë shitje me kupon janë 123.al, zero.al, tag.al, kuponi.al, etj.

Nga një vëzhgim i bërë këtij sektori, vërehet që këto sipërmarrje e-commerce në Shqipëri, realizojnë në xhiro totale mujore rreth njëqind mijë euro, ndërsa vërehet rritje e konsiderueshme nga viti në vit. Vitin e kaluar (2014), nga përllogaritja e bërë konstatohet se xhiroja mujore mesatare e sipërmarrjeve kryesore e-commerce në Shqipëri ka qenë rreth 60-70 mijë euro.

Sipërmarrësit e këtyre aktivitetëve shprehen optimist për të ardhmen e e-commerce në Shqipëri. Mendim i përbashkët është që rritja nga viti në vit do të jetë dyshifror, që është premtuese për të ardhmen e këtij sektori.

Por, e ardhmja e e-commerce në Shqipëri shihet pozitive edhe nga studiues të kësaj fushe.

“Në këtë periudhë, kur kriza ekonomike është rritur në të gjitha vendet, axhenda e Bashkimit Europian është e përqendruar në rritjen e përpjekjeve për përfitime nga përdorimi i teknologjisë së informacionit, si një mënyrë e shpejtë për të tejkaluar krizën. Edhe pse Shqipëria nuk është pjesë e Bashkimit Europian, përdorimi i teknologjisë së informacionit do të jetë një mënyrë e mirë për bizneset që veprojnë në Shqipëri që ta tejkalojnë sa më mirë krizën dhe të vazhdojnë me sukses aktivitetin e tyre” (Açka, 2012)

Ndryshe nga Ballkani ku sipërmarrjet e-commerce janë në fillimet e saj, gjendja në pjesën e Europës Perëndimore është krejt ndryshe. Në këtë rajon që përfshin Belgjikën, Francën, Irlandën, Luksemburgun, Holandën dhe Mbretërinë e Bashkuar, kemi nivelin më të lartë të madhësisë së e-commerce, duke zënë 51% të tregut europian. Në vitin 2013 totali i e-commerce (B2C - biznesi te konsumatori) në Europës Perëndimore arriti në 177.7 miliardë euro, një zgjerim prej 20% me bazë vjetore. Shitjet online të mallrave dhe shërbimeve në të gjithë Evropën vlerësohet të kenë arritur në 364.3 miliardë euro në 2013 ose 317.9 miliardë euro vetëm në vendet e BE-së, thuhet në Raportin e “Ecommerce Europe” për Evropën Perëndimore.

Ndërkohë sipas Raportit të “Ecommerce Europe” për Evropën Lindore, niveli më i ulët i përdorimit të biznesit e-commerce ndër vendet e Evropës, vërehet në shtetet e Europës Lindore. Në vitin 2012, xhiro e e-commerce në ekonomitë në zhvillim të Ruisisë, Bullgarisë, Rumanisë dhe shteteve të tjera arriti në 13.4 miliardë euro, një zgjerim me 32.6% në krahasim me 2011-n. Shteti kryesues edhe për sa u përket termave të popullsisë më premtuesi në tregun e-commerce në këtë pjesë të Evropës është Rusia, me një rritje prej 33%. Në vitin 2013, shitjet online të mallrave dhe shërbimeve në të gjithë Evropën Lindore vlerësohet të kenë arritur në 19.3 miliardë euro, që është dukshëm më e ulët se në vendet e Evropës perëndimore por me një rritje nga një vit më parë. (<http://www.ecommerce-europe.eu/facts-figures/infographics/southern-europe-2013>)

Janë të shumta arsye pse kjo lloj sipërmarrjeje nuk është zhvilluar në vendin tone me hapa të njëjtë me ata të pjesës tjetër të Evropës, pavarësisht që kapitali fillestar i nevojshëm për të nisur një lloj aktiviteti në internet është dukshëm më i ulët se sa në ekonominë reale. Nga intervistat me drejtues të këtyre sipërmarrjeve në Shqipëri, është vënë re se të gjithë kanë analiza të ngjashme për pengesat që kjo lloj sipërmarrjeje has në vendin tonë.

Shumica mendojnë se arsyeja kryesore është numri i popullsisë dhe niveli i përdorimit të internetit, që është dukshëm më i ulët sesa në pjesën tjetër të Evropës. Ky fakt, “zvogëlon” edhe më shumë tregun, që edhe ashtu është i vogël për shkak të numrit të vogël të popullsisë së Shqipërisë.

Një arsye tjetër është mungesa e ofertave joshëse dhe lehtësirave që bankat sigurojnë në vendet e tjera për sipërmarrësit e këtij sektori dhe që mungojnë dukshëm në vendin tonë. Mungesa e mbështetjes nga bankat për këtë sektor konstatohet se është për shkak të volumit ende të ulët që qarkullon ky segment.

Një tjetër problem, sado i vogël të duket por i rëndësishëm për sipërmarrësit në këtë treg, është edhe mënyra e faturimit të produkteve, ku vërehen raste të refuzimit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të kërkesave të disa prej këtyre sipërmarrjeve për lëshim të faturave elektronike, të cilat do të thjeshtonin dhe lehtësonin funksionimin e këtyre aktiviteteve të bazuara plotësisht në sisteme informacioni. Refuzimi i kërkesave është bërë me arsyetimin se nuk plotësojnë kriterin e volumit. Si pasojë, pamundësia për të lëshuar faturë elektronike, detyron sipërmarrjen që për çdo shitje të përgatis faturë të shkruar dorazi, në vend të faturës që gjenerohet automatikisht nga sistemi e që do të përshpejtonte procesin e shërbimit si dhe do të ulte koston për sipërmarrjen.

5. Përfundim

Nga shqyrtimi i literaturës, trajtimi i teorive të ndryshme të sipërmarrjes ndër vite dhe analizimi i sistemeve të informacionit dhe teknologjisë vërehet se sistemet e informacionit kanë ndikuar në daljen në skenë të një lloji të ri sipërmarrësish dhe sipërmarrjesh, që sot njihen si e-sipërmarrës, sipërmarrës të cilët aktivitetin e tyre e kanë të fokusuar në ekonominë e internetit.

Zhvillimi i teknologjisë dhe sistemeve të informacionit, si dhe përhapja e përdorimit të internetit kanë ndikuar dukshëm në rritjen e kësaj kategorie sipërmarrjesh, të cilat sot në Evropë përbëjnë një zë të rëndësishëm në transaksionet tregtare. Tashmë një pjesë e madhe e shërbimeve mund të merren përmes internetit, duke zënë vendin e formës klasike të bërjes biznes, atë të dyqaneve fizike.

Kjo ecuri, ka vite që ekziston edhe në Shqipëri. Fillimisht me hapjen e portaleve informative në internet në vitet 2000, të cilët u ofrojnë konsumatorëve (lexuesve) informacione në kohë reale, lehtësisht të aksesueshme nga platforma të ndryshme (kompjuter, celular, tablet, smart tv, etj), të pasuruara me foto dhe video si dhe duke ofruar interaktivitet me lexuesin. Përveç kësaj, këto shërbime janë plotësisht pa pagesë ndërsa sipërmarrjet e këtij lloji të ardhurat e tyre i gjenerojnë nga palët e treta të cilët reklamojnë shërbimet dhe produktet e tyre në këto platforma.

Më vonë, pas vitit 2010, në Shqipëri shfaqen edhe sipërmarrjet e para e-commerce, të cilat ofrojnë produkte dhe shërbime të ndryshme përmes internetit. Për shkak të mangësive të shumta në infrastrukturë, tregut të vogël, etj. një pjesë e këtyre sipërmarrjeve kanë falimentuar pak kohë pas themelimit ndërsa ato që kanë arritur të mbijetojnë fazën e fillimit, tashmë kanë filluar të konsolidohen duke arritur edhe të shënojnë fitime në aktivitetin e tyre, pavarësisht që janë sipërmarrje të reja.

Si përfundim, nga literatura e shqyrtuar si dhe nga analizimi i rasteve në Shqipëri dhe jashtë, vërehet se sistemet e informacionit janë baza mbi të cilën ngrihen e-sipërmarrjet ndërsa e-sipërmarrësit ushtrojnë aktivitet tregtar në një format të ri, ndryshe nga ai klasiku, duke shfrytëzuar avantazhet e teknologjisë dhe të internetit.

Bibliografia

- Havinal, V. (2009). *Management and Entrepreneurship. Entrepreneurship - Evolution of Concept of Entrepreneur*. (pp. 95). New Delhi: New Age International (P) Limited Publishers. ISBN (13): 978-81-224-2659-5
- Brewer, A. (1992). *Richard Cantillon: Pioneer of Economic Theory*. Routledge. ISBN 978-0-415-07577-0.
- Navale, A. B. (2013). Developing Entrepreneur Skills for Corporate Work. *Research Directions* 1 (4). ISSN 2321-5488.
- Hebert, R. and Link, A. (2009). *A History of Entrepreneurship*. New York: Routledge
- Anchorena, J. and Ronconi, L. (2013). *Entrepreneurship, Entrepreneurial Values, and Public Policy in Argentina. Entrepreneurship in Latin America: A Step Up the Social Ladder?* Edited by Lora, E. & Castellani, F. Washington: Inter-American Development Bank and World Bank Publications
- Sharma, K.P. (2008) *Entrepreneurship*. 2nd Edition. New Delhi: V.K. Enterprises
- Porter, M. E. (1990), *The Competitive Advantage of Nations*, New York: Free Press.
- Holmes, T.J. and J.A. Schmitz Jr. (1990), A theory of entrepreneurship and its application to the study of business transfers, *Journal of Political Economy* 98, 265-294.
- Evans, D.S. and L.S. Leighton (1989), Some empirical aspects of entrepreneurship, *American Economic Review* 79, 519-535. Sahlman, W.A., Stevenson, H.H., Roberts, M.J. and Bhide, A.V. (1996). *The Entrepreneurial Venture*. Boston, MA: Harvard Business School Press.
- Schumpeter J. A. (1965). Economic Theory and Entrepreneurial History. In: Aitken HG (ed) *Explorations in enterprise*. Harvard University Press, Cambridge, MA
- Matlay, H. (2004) 'E-entrepreneurship and small e-business development: towards a comparative research agenda', *Journal of Small Business and Enterprise Development*, Vol. 11, pp.408-414.
- Kollmann, T. (2001) 'Measuring the acceptance of electronic marketplaces', *Journal of Computer Mediated Communication*, Vol. 6, No. 2.
- Jelassi, T. and Enders, A. (2005) *Strategies for e-Business. Creating Value through Electronic and Mobile Commerce*, New York: Prentice Hall, p.3.
- Hagel, J. and Singer, M. (1997) *Net Gain*, Boston, Harvard Business School Press, p.35.
- Tapscott, D. (1996) *The Digital Economy. Promise and Peril in the Age of Networked Intelligence*, New York, McGraw-Hill.
- Kollman, T. (2006) 'What is e-entrepreneurship? – fundamentals of company founding in the net economy', *International Journal of Technology Management*, Vol. 33, No. 4.
- Porter, M.E. and Millar, V.E. (1985) 'How information gives you competitive advantage', *Harvard Business Review*, Vol. 63, No. 4, pp.149-160.
- Weiber, R. and Kollmann, T. (1998) 'Competitive advantages in virtual markets – perspectives of "Information-based Marketing" in cyberspace', *European Journal of Marketing*, Vol. 32, Nos. 7/8, pp.603-615.
- Porter, M.E. (1985) *Competitive Advantage*, New York, Free Press.
- Covin, J., & Slevin, D. (1991) A Conceptual Model of Entrepreneurship as Firm Behavior? *Entrepreneurship Theory and Practice*, Vol. 16, 7-25.
- Morris, M. H., & Sexton, D. (1996) "The Concept of Entrepreneurial Intensity: Implications for Company Performance," *Journal of Business Research*, Vol.36, No.1, 5-13.
- Pearse J. M., Graffman L., Colledge Th., and Legg R., (2008) Leveraging Information Technology, Social Entrepreneurship, and Global Collaboration for Just Sustainable Development, *Proceedings of 12th Annual National Collegiate Inventors and Innovators Alliance Conference*, 201- 210.
- Deans, P. C., and Kane, M. J. (1992) *Information Systems and Technology*, Boston, MA: PWS-Kent Publishing
- Janson M.A. & Wrycza S. Information Technology and Entrepreneurship: Three Cases from Poland; the Center for International Studies and the Office of Research, University of Missouri-St. Louis. Parë për herë të fundit me 11/04/2015 nga <http://www.umsl.edu/~jansonma/myarticles/poland3.pdf>
- Schumpeter, J.A. (1911) *The Theory of Economic Development: An Inquiry into Profits, Capital, Credit, Interest and the Business Cycle*. 1934 Translation, Cambridge, Mass: Harvard University Press.
- Açka, Sh. (2012) "E-commerce like a quickly manner for economic development- Albanian case," *Proceedings EIIC (Proceedings in EIIC - 1st Electronic International Interdisciplinary Conference)*, ISBN: 978-80-554-0551-3, ISSN: 1338-7871, vol. 1, issue 1, pp. 354-358
- Raporti i Ecommerce Europe për Evropën Perëndimore (2014) Për herë të fundit me 10/04/2015 <http://www.ecommerce-europe.eu/facts-figurës/infographics/western-europe-2013>
- Raporti i Ecommerce Europe për Evropën Lindore (2014) Për herë të fundit me 10/04/2015 <http://www.ecommerce-europe.eu/facts-figures/infographics/eastern-europe-2013>

HUAT ME PROBLEME: ZGJIDHJE PËRTEJ KONTEKSTIT TRADICIONAL

PROF. ASOC. DR. ELVIN MEKA

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti Ekonomik, Financë
elvin.meka@uet.edu.al

ABSTRAKT

Huat me probleme vijojnë të mbeten çështja kryesore e sistemit bankar shqiptar, që nga viti 2009, kur filloi rritja e theksuar e këtij treguesi. Bankat tregtare, Banka e Shqipërisë dhe qeveria shqiptare janë përpjekur në vite të menaxhojnë një problematikë të tillë, duke shfrytëzuar të gjithë hapësirat e lejuara të legjislativimit në fuqi, si dhe duke ofruar qasje të reja, me synim uljen e një treguesi të tillë dhe minimizimin e efekteve negative që si sjell në vijueshmërinë e huadhënies dhe zgjerimit të ekonomisë.

Pavarësisht nga këto përpjekje, nisur dhe nga konteksti i krizës globale ekonomiko – financiare dhe pasojave të saj në ekonominë europiane, rajonale dhe atë shqiptare, efektiviteti i këtyre masave ka qenë i kufizuar, duke nxjerrë në pah nevojën për konsiderimin e modeleve alternative, që dalin jashtë kuadrit tradicional të menaxhimit dhe zgjidhjes së çështjes së huave me probleme, gjatë periudhave normale dhe ciklit zgjerues të ekonomisë.

Në punim analizohen arsyet themelore që kushtëzuan rritjen e shpejtë të huave me probleme dhe mos uljen e treguesit të huave me probleme brenda sistemit bankar shqiptar, ndërkohë propozohet rishikimi i platformës aktuale të Bankës së Shqipërisë, duke përshtatur Modelin “Podgorica”, si një model alternativ jo tradicional, por eficient, i trajtimit të huave me probleme për sistemin bankar shqiptar.

Fjalë kyç: *Hua me probleme, huadhënie, modeli “Podgorica”, kriza ekonomiko-financiare.*

1. Hyrje

Huat me probleme vijojnë të mbeten një prej problematikave më të mprehta brenda sistemit bankar dhe financiar shqiptar, por jo vetëm. Praktikisht, çështja e huave me probleme ka filluar dhe po vijon të jetë fokusi kryesor mbi të cilin është përqendruar vëmendja e të gjithë grupeve të interesit të sistemeve financiare kudo në botë, veçanërisht pas shpërthimit të krizës financiare dhe ekonomike të vitit 2008. Është lehtësisht e evidentueshme që huat me probleme kanë njohur vetëm rritje thuajse në të gjithë botën, veçanërisht në vendet e rajonit të Ballkanit, por jo vetëm, pasi edhe vende të OECD-se dhe të BE-së po ballafaqohen me një nivel të lartë të tyre, si psh: Italia dhe Greqia.

Nga ana tjetër, prirja rritëse e huave me probleme nuk është i vetmi shqetësim, pasi një fenomen i tillë është i kuptueshëm dhe evident sidomos pas shpërthimit të krizave ekonomike dhe financiare, si dhe nga natyra prociklike e zhvillimit dhe funksionimit të sistemit financiar. Tashme, duket se vëmendjen më të madhe po e merr vështirësia dhe pamundësia për ta adresuar në mënyrë energjike këtë çështje, si dhe minimizuar efektin e faktorëve që ndikojnë në mos uljen apo reduktimin e madhësisë së tyre përgjatë viteve.

Në kontekstin shqiptar, Banka e Shqipërisë ka marrë me kohë një pozicion aktiv në adresimin e kësaj çështjeje madhore për sistemin bankar shqiptar, nëpërmjet hartimit të një platforme specifike për këtë qëllim, bazuar në Nismën e Vjenës dhe marrëveshjes me Fin SAC-un e Bankës Botërore. Gjithsesi, mund të konstatohet se pavarësisht kësaj, ende treguesi i huave me probleme vijon të mbetet i lartë dhe faktorët që i mbajnë huat me probleme në një nivel të tillë vijon të jenë ende me ndikim shumë të fortë apo përpjekjet e bëra nuk kanë mundur të ridimensionojnë rolin e tyre, me qëllim uljen e qëndrueshme të këtij treguesi.

2. Qëllimi dhe objektivat

Ky punim ka për qëllim të evidentojë shkaqet dhe arsyet pse treguesi i huave me probleme në Shqipëri ka njohur vetëm rritje dhe shkaqet pse nuk po arrin të shënojë ulje të dukshme në vijim, si dhe pse huat me probleme meritojnë një vëmendje të veçantë nga vetë bankat dhe rregullatorët.

Gjithashtu, punimi synon të hedhë dritë mbi aspektet kryesore të platformës së Bankës së Shqipërisë për trajtimin e huave me probleme dhe krahasimin e saj me Modelin “Podgorica”, të zbatuar nga Mali i Zi, për reduktimin e huave me probleme. Qëllimi është të evidentohet rëndësia që ka zbatimi i parimit të vullnetarizimit të biznesit në vështirësi në ristrukturimin e huave me probleme dhe përfshirja në platformë edhe të grupeve të tjera të interesit si: qeveria, bizneset dhe shoqata e bankave.

Konkretisht, punimi sugjeron që platforma ekzistuese e bankës së Shqipërisë duhet të plotësohet më tej edhe me ato aspekte të pa trajtuara dhe të pambuluara, me qëllim përmbushjen e objektivit madhor të uljes së treguesit të huave me probleme dhe prodhimin e efekteve pozitive për të gjithë grupet e interesit, që ndikohen nga niveli i lartë i huave me probleme.

3. Huat me probleme – Pse kanë shumë rëndësi për bankat?

Nuk përbën aspak rastësi që çështja e huave me probleme tërheq ndoshta vëmendjen kryesore të menaxhimit të lartë të çdo banke, pasi një nivel i lartë i këtyre huave nënkupton:

Shkallë më e ulët përfitueshmërie për bankën

Sipas Jassaud & Kang (2015), huat me probleme përbëjnë një “barrë negative” për bankën, pasi ato thjesht nuk gjenerojnë të ardhura për bankën, në një kohë banka duhet të vijojë të financohet me norma interesi të tregut. Nga ana tjetër, një fakt i tillë ushtron një trysni rritëse mbi normat e interesit të huave standarde dhe atyre në ndjekje, që u duhet të kompensojnë humbjet që vijnë nga huat me probleme. Ndërkohë, Murgasova et .al (2015) pohon se një nivel i lartë i huave me probleme mund të përbëjë dhe një kërcënim për stabilitetin financiar.

Kosto e vazhdueshme operacionale

Prania e huave me probleme në bilancet e bankave vijojnë që të “thithin” prej bankave një sasi të caktuar të kostos së përgjithshme operacionale, pasi banka vijon të angazhohet për to burime njerëzore, si dhe të paguajë kosto të ndryshme financiare, administrative dhe ligjore.

Kosto më e lartë për fonde të reja

Bankat që përjetojnë nivele të larta të huave me probleme kanë vështirësi në tërheqjen e fondeve të reja për financimin e veprimtarisë së tyre nga operatorë e tjerë në tregun financiar, ndërkohë që rrit trysninë për injektimin e fondeve të reja nga aksionarët e bankës.

Shkallë më e lartë e mbulimit të rreziqeve

Rritja e treguesit të huave me probleme çon automatikisht në rritje të fondit të provigjoneve për bankën, që ndikon drejtpërdrejt jo vetëm në përfitueshmërinë e bankës dhe kthimin mbi kapitalin aksionar, por e detyron bankën të angazhojë më tepër kapital dhe të kërkojë më shumë interes nga huat e reja, me qëllim mbulimin më të mirë dhe më të plotë të marzhit të rrezikut që ajo merr përsipër për huat që akordon në vijim.

Vështirësi për likuiditet në të ardhmen

Bllokimi për një kohë të gjatë i një pjese të investimeve të bankës në hua me probleme ndërlikon situatën e bankës në raport me klientët e saj depozitues, kur këta të fundit kërkojnë tërheqjen e fondeve, duke e vendosur bankën në vështirësi likuiditeti.

Pengesë për zhvillimin ekonomik

Murgasova et. al (2015) thekson se stoku i lartë i huave me probleme ka prirje të kufizojë veprimtarinë ekonomike të huamarrësve me ekspozim të lartë ndaj huamarrjes dhe dekurajon shpërndarjen efikase të burimeve drejt përdoruesve produktivë. Nëse çështja e huave me probleme vazhdon të mos zgjidhet apo lehtësohet, ajo shton rrezikun e mbajtjes së kreditimit në nivele të ulëta dhe me ritme të ngadalta, duke ndikuar në ngadalësimin e investimeve dhe rritjes ekonomike, në periudhë afatshkurtër dhe afatmesme. Sikundër thekson dhe Abiad et. al (2011), nisur nga vështirësitë në të cilat gjendet sektori financiar, tkurrja e rrjedhave ndërkuftare të kapitalit, si dhe krijimi i flluskave të huadhënies dhe pasurive të paluajtshme në disa vende, procesi i rimëkëmbjes nga kriza ka të ngjarë të realizohet pa ndihmën e huave në një numër të caktuar ekonomish, pra rrjedhimisht më e ngadaltë se sa mesatarja. Gjithashtu, niveli i dobët i huadhënies rëndon dukshëm mbi kërkesën agregate, por ajo gjithashtu lidhet ngushtë dhe ndikon shumë dhe mbi ofertën agregate dhe ndryshimet sektoriale, pasi bie niveli i investimeve.

4. Situata aktuale e huave me probleme në Shqipëri

Përkeqësimi i portofolit të huave në sistemin bankar

Huat me probleme përbëjnë një prej çështjeve të sistemit financiar drejt të cilës ka një vëmendje të shtuar dhe të vazhdueshme, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajon e në gjithë botën. Sipas Goldstein & Weatherstone (2001), në literaturën ekonomike dhe financiare një nga 3 simptomat e një krize të mundshme bankare është kur raporti i huave me probleme ndaj totalit të huave në sistemin bankar tejkalon vlerën prej 10 për qind. Nga ana tjetër, niveli i lartë i huave me probleme përfaqëson dhe shenjën më të qartë të pasojave të krizës më të fundit ekonomiko-financiare globale, si dhe të nivelit zhvillimit tejet anemik të zhvillimit të ekonomisë botërore dhe asaj të rajonit, por jo vetëm.

Në kontekstin rajonal dhe global, Shqipëria nuk bën ndonjë përjashtim të veçantë nga problematika e këtyre lloj huave, të cilat që pas shpërthimit të krizës financiare globale kanë shënuar vetëm rritje, të paktën deri në fund të tremujorit të katërt të vitit 2014 (Grafiku 2). Pavarësisht se Shqipëria është goditur fillimisht tërthorazi nga kriza, treguesi i këtyre huave e tejkaloi shifrën prej 10 për qind që brenda vitit 2009.


Sikundër thekson dhe Murgasova et. al (2015), huat me probleme u rritën dukshëm në vendet ku rritja e huave gjatë periudhës së para krizës ishte shumë e fortë dhe ku rënia ekonomike ishte po ashtu e fortë dhe e thellë. Shqipëria shfaq

GRAFIKU 1



Burimi: Banka e Shqipërisë

GRAFIKU 2



Burimi: Banka e Shqipërisë


TABELA 1: ECURIA E PORTOFOLIT TE HUAVE Ë SISTEMIT BANKAR SHQIPTAR 2005 – 2014

në milionë lekë

Treguesi	Dhje. 2005	Dhje. 2006	Dhje. 2007	Dhje. 2008	Dhje. 2009	Dhje. 2010	Dhje. 2011	Dhje. 2012	Dhje. 2013	Dhje. 2014
Huat për korporata jofinanciare provate	152,114	303,085	185,972	254,95	287,536	325,253	383,052	394,774	388,502	401,125
Huat për ekonomitë familjare	41,245	68,428	107,794	140,938	146,829	149,087	148,858	149,602	149,591	145,302
TOTALI	193,359	371,513	293,766	395,888	434,365	474,340	531,910	544,376	538,093	546,427

Burimi: Banka e Shqipërisë

GRAFIKU 3



Source: Albanian authorities and IMF staff calculations.

pikërisht një pirje të tillë të rritjes së shpejtë së huave me probleme, si dhe një ulje thelbësore të ritmeve të rritjes ekonomike, pavarësisht nga fakti i mos rënies në recesion ekonomik.

Sipas Nazaj & Meka (2014), bankat tregtare e “pagan” vullin drejt huadhënies (Tabela 1) me koston e një portofolit huash me cilësi të ulët, i shkaktuar prej shmangies nga kërkesat minimale themelore të cilësisë së huas, ose të ashtuquajturat

TABELA 2: KLASIFIKIMI I HUAVE NGA BANKAT

Klasifikimi	Nr i ditëvonesave	Provizionet (në %)	Klasifikimi i huas
1	0 – 30	1%	Standarde
2	31 – 90	5%	Në ndjekje
3	91 – 180	20%	Nënstandarde
4	181 – 365	50%	Të Dyshimta
5	366 -	100%	Të humbura

Burimi: Banka e Shqipërisë

“Pesë K-të”. Disa banka që ishin mjaft agresive në kreditim gjatë periudhës 2006 - 2009, nëpërmjet normave të ulëta të interesit, të ndihmuara nga kosto e ulët e fondeve që ofroheshin prej bankave të tyre mëmë, ofruan një numër të madh huash, bazuar thjesht në cilësinë e kolateralit dhe vlerën e tij, duke anashkaluar K-të e tjera.

Sigurisht që në totalin e huave me probleme, kontribuesi më i madh është komponenti i huave për biznes (korporatat jo financiare) dhe më pak ai i huave për individë (Grafiku 3). Gjithashtu, nëse shihet ecuria e cilësisë së huave, është fakt që huat për biznes rezultojnë me një cilësi më të ulët, në krahasim me ato për individë. Nisur dhe nga struktura e portofolit të huas (Tabela 1), ku pjesën dërrmuese e përbëjnë huat për biznesin, efekti negativ i treguesit të huave me probleme përforcohet edhe më shumë, përveç faktit dhe efektit të kundërt që jep frenimi i huadhënies së re për ekonominë.

Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë (2011): “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, bankat janë të detyruara të bëjnë mbi baza mujore klasifikimin e huave, në një nga kategoritë e mëposhtme:

Sikundër shihet dhe nga grafiku 1, që nga viti 2010 e në vijim përkeqësimin më të madh e ka shënuar kategoria 5, pra ajo e huave të humbura dhe pa shpresë arkëtimi.

Huat me probleme në Shqipëri dhe vështirësitë për uljen e tyre

Pavarësisht nga fakti i rritjes së fortë të huave me probleme në Shqipëri, pas shpërthimit të krizës globale ekonomike dhe financiare të vitit 2008 dhe stabilizimit të treguesit të huave me probleme gjatë viteve 2013-2014, ajo që është e rëndësishme dhe meriton vëmendje është fakti që pavarësisht nga shtrëngimi i kriterëve të huadhënies dhe masave që kanë marrë bankat gjatë viteve të fundit, përsëri sistemi bankar shqiptar po has vështirësi në uljen e këtij treguesi. Ekzistojnë disa faktorë që, drejtpërdrejt apo tërthorazi, pengojnë bankat në arritjen e rezultateve në dukshme, në përpjekjen për uljen e nivelit të lartë të huave me probleme, si më poshtë:

Procedura të stërzgatura ligjore dhe sistem joefikas gjyqësor për ekzekutimin e kolateralit.

Është fakt në Shqipëri që një procesi i ekzekutimit të kolateralit dhe procedurat e stërzgatura gjyqësore mbeten ndër hallkat e dobëta dhe që krijojnë problematikën më të mëdha për bankat në drejtim të trajtimit efikas të huave me probleme. Kjo inefficiencë sistemit gjyqësor përbën një prej katalizatorëve kryesorë të një situatë të tillë ngërçi në drejtim të mos uljes së treguesit të huave me probleme. Nga ana tjetër, Murgasova et .al (2015) parashtron se në Shqipëri janë bërë reforma—për shembull përmirësimi i fundit në trajtimin fiskal të huave të fshira dhe hapa për të përmirësuar ekzekutimin e kolateralit, por ka pasur shumë pak përmirësim në terren, për shkak të zbatimit të dobët të tyre. Banka Botërore (2013) thekson se amendimet e vitit 2013 në Kodin e Procedurës Civile, të miratuara me mbështetjen e Fin SAC, synojnë të shkurtojnë dhe thjeshtojnë procedurat e zbatimit të kolateralit dhe reduktojnë në mënyrë të konsiderueshme të drejtën e gjykatave për të ndërhyrë në zbatim ose ekzekutim të pronave të paluajtshme. Megjithatë, bankat vazhdojnë të përballen me paqartësi të rëndësishme tatimore në përpjekjet e tyre për të hequr kreditë e këqija (NPL-të) e parikuperueshme.

Mungesa e tregut dytësor të huave me probleme dhe e procesit të titullizimit.

Shqipëria nuk ka një treg dytësor të krijuar dhe funksional për tregtimin huave dhe aktiveve me probleme. Shitja e huave me probleme të shoqëritë e specializuara është eksperiencë vetëm e viteve të fundit, ndërkohë që procesi i titullizimit të këtyre lloj aktiveve është ende i panjohur. Çeliku (2015) thotë se sistemi bankar në Shqipëri vetëm vitet e fundit është bërë më agresiv dhe ka paraqitur në treg mjete e teknika të reja, në kuadër të dimensionit të mbledhjes së huave me probleme. Gjatë kësaj periudhe hynë të treg aktorë të rinj, si: shoqëritë private të mbledhjes së huave me probleme, zyrat përmbarimore private që zëvendësuan ato shtetërore, ndërkohë që dhe kuadri ligjor për ekzekutimin e kolateralit u përmirësua.

Ngurrimi për fshirjen e huave të humbura nga bilanci e bankave, nisur nga legjislacioni jo i qartë tatimor dhe mungesa e lehtësive fiskale

Fshirja e huave të humbura nga bilanci i bankave është një teknikë që përdoret gjerësisht kudo dhe patjetër që ajo do të lehtësonte procesin e huadhënies dhe logjikisht do të ulte nivelin e huave me probleme në banka. Gjithsesi, duhet pranuar se legjislacioni shqiptar ka qenë deri vonë i paqartë rreth trajtimit fiskal dhe njohjen e fshirjes së huave të humbura si shpenzim i zbritshëm. Edhe Ziu (2014) pohon se hapësirat ligjore fiskale kanë ndikuar negativisht në stepjen e bankave, në drejtim të

fshirjes së huave për shkak të hapësirave të interpretimit që krijohen. Kjo ka kushtëzuar bankat të hezitonin të ndërmerrnin një fshirje masive të huave të humbura, të cilat zënë pjesë jo të vogël të huave me probleme. Konkretisht, duhej pritur deri në prill të vitit 2014, ku amendimet dhe shtesat në ligjin nr.8438, “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar”, i japin mundësi bankave të fshijnë huat e humbura, fshirje kjo që tashmë njihet si shpenzim i zbritshëm, duke mos i rënduar shpenzimet e bankave. Gjithashtu, ndryshimet e bëra në Kodin e Procedurës Civile kishin si qëllim rritjen e efikasitetit të procesit të ekzekutimit të kolateraleve, si në drejtim uljes së burokracive, ashtu edhe në drejtim të lehtësimit të kushteve të likuidimit të pronave të lëna si kolateral, duke gjetur një përputhje më të madhe me ofertat e tregut.

Tatimi i “padrejtë” i të ardhurave të bankave, lidhur me provizionet për huat që konsiderohen si shpenzime të zbritshme.

Sipas Polo (2012), deri në fund të vitit 2010, neni 25 i ligjit “Për të tatimin mbi të ardhurat”, përcaktonte se: “Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm vjetor, janë shpenzime të njohura provizionet e bankave, të krijuara sipas rregullave të Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim. Shumat e rimarra nga këto rezerva apo provizione i shtohen fitimit të tatueshëm”. Në vijim, në dhjetor të vitit 2010, po në këtë nen të këtij ligji bëhet një ndryshim i veçantë, që hyri në fuqi në janar të vitit 2011, sipas të cilit tashmë përkufizimi i provizioneve të bankave merr një kuptim tjetër, e konkretisht ky nen përcakton që: “Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të bankave, janë shpenzime të njohura, provizionet e bankave të krijuara në përputhje me standardet e hartuara nga Bordi i Standardeve Kontabël Ndërkombëtare dhe të certifikuara pa vërejtje nga auditues të jashtëm, por në çdo rast, pa tejkalar masën e përcaktuar në rregullat e Bankës së Shqipërisë, për këtë qëllim. Shumat e rimarra nga këto rezerva apo provizione i shtohen fitimit të tatueshëm”. Pra me pak fjalë, në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të bankave, do të njiheshin si shpenzime për provizione, herë provizionet e përlllogaritura në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit e herë provizionet e krijuara për qëllime statutoare (sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë), ku gjithnjë do të njihen si shpenzime të zbritshme shuma më e vogël e provizioneve të krijuara, nga të dy standardet.

Me ndryshimet respektive të vitit 2014, një klauzolë e tillë është hequr, duke korigjuar trajtimin e “padrejtë” që i bëhej fitimit faktik të bankave nga procesi i njohjes dhe zbritjes së shpenzimeve për provizione. Gjithsesi, një trajtim i tillë fiskal ka kushtëzuar jo pak sipërmarrjen e bankave drejt zgjidhjes së çështjes së huave me probleme.

Organizmi i përmbauesve privatë kryesisht si shërbim i mbledhjes së huave me probleme dhe mungesa e shërbimeve të mirëfillta dhe në përmasa të mëdha të faktoringut, si dhe rregullat konservatore për blerësit e huave me probleme. Çeliku (2015) thekson se aktualisht nuk ka ndonjë udhëzues, apo rregullore të publikuar nga Banka e Shqipërisë, që të rregullojë specifikisht këtë veprimtari, ndaj për realizimin e tij u përshtatën ato ekzistuese, të cilat prodhuan një version konservator të rregullimit të tij, e cila kufizonte blerësit vetëm te ata që kishin një licencë huadhënieje, gjë që nuk është praktikë në vendet e zhvilluara. Nga ana tjetër, zyrat e përmbauesve privatë janë teknikisht të organizuara si shërbim i mbledhjes së huave me probleme (dhe paguhen me tarifë suksesi), ndërkohë që ende mungojnë shërbime të mirëfillta dhe në përmasa të mëdha të faktoringut (shoqëri të tilla ekzistojnë por blerja e huave të humbura prej tyre është vetëm në shuma të vogla), që do të mundësonte pozicionimin e këtyre të fundit si shoqëri tipike të menaxhimit të aktiveve me probleme, duke i dhënë jetë edhe tregut dytësor të tyre, si dhe në një fazë të dytë, një procesi të mundshëm titullizimi.

5. Adresimi aktual i huave me probleme dhe nevoja për një qasje të re

Në vijim të një sërë iniciativash ligjore dhe rregullative, me synim reduktimin e kredive me probleme dhe nxitjen e procesit të kreditimit në vend, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një iniciativë të posaçme, në bashkëpunim me Qendrën Këshilluese të Sektorit Financiar (Fin SAC) të Bankës Botërore, për adresimin e mëtejshëm të ristrukturimit të kredive. Ky angazhim i Bankës së Shqipërisë është vjen në kuadër të Nismës së Vjenës II dhe Fin SAC-ut.

Platforma e Bankës së Shqipërisë për adresimin e huave me probleme

Ziu (2014) thekson se Banka e Shqipërisë e ka shfaqur që në fillim të herës shqetësimin për shfaqjen e fenomenit të huave me probleme dhe ka paralajmëruar bankat për të marrë masat e nevojshme paraprake, për t'i paraprirë kësaj dukurie, që mund të përmbledhen në: rritjen e cilësisë së menaxhimit të rreziqeve, krijimin e strukturave të përshtatshme, kryerjen në kohë dhe në mënyrë të shëndetshme të ristrukturimeve të huave, kryerjen e analizave së provës së rezistencës (*stress-test*) dhe rritjen e burimeve kapitale në përputhje me rezultatet e analizave.

Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë ka hartuar një platformë specifike, që në tetor 2012, qëllimi i së cilës është analiza dhe trajtimi i huamarrësve me probleme, ose atyre që kanë filluar të shfaqin probleme në portofolet e bankave të veçanta, nën dritën e eksperiencës ndërkombëtare për hartimin e planeve të rimëkëmbjes dhe të zgjidhjes për këto lloj kredimarrësish.

Përmbledhtazi, kjo platformë e Bankës së Shqipërisë mbështetet në këto shtylla kryesore:

Bankat duhet të raportojnë:

të gjitha huat e dhëna për biznes, përveç atyre të klasifikuara si “standarde”,

kërkesat për të dhënat financiare të tij për tre vitet e fundit si dhe për kolaterale të lëna peng.

Përzgjedhje e disa bizneseve, mbi bazën e një sërë faktorësh, si:

- 0 madhësia e huasë,
- 1 sektori ekonomik ku operon,
- 2 vendndodhja gjeografike,
- 3 niveli i ekspozimit në sistem, etj.

Bankave do t’u kërkohet, për secilin prej huamarrësve të përzgjedhur, përgatitja e planeve të rikuperimit të tyre.

Duhet të theksohet se kjo platformë synon një angazhim më të madh të bankave në procesin e ristrukturimit të huave, por pavarësisht nga sa më lart, ajo funksionon thelbësisht në një qark të mbyllur banka - Banka e Shqipërisë, dhe nuk përfshin edhe grupe të tjera interesi, që gjykohen të përshtatshme dhe nevojshme për t’u përfshirë në të. Në këtë kuadër, gjykohet me shumë rëndësi që platforma aktuale e Bankës së Shqipërisë të mund të ridimensionohet dhe rishikohet, me qëllim që të mund të sigurohen efekte më të dukshme dhe rezultate më të prekshme, në drejtim të uljes thelbësore të huave me probleme.


Modeli “Podgorica” – një qasje për t’u konsideruar nga Banka e Shqipërisë

Siç thekson dhe Impavido et. al (2012), e ardhmja ekonomike jo fort optimiste për vendet e Europës, Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESE) sugjeron që “sigurimi i rritjes ekonomike duke abstraguuar nga çështja e huave me probleme” mund të mos jetë alternativa më realiste për të gjithë rajonin. Në këtë kuadër, nevojitet një qasje më pro-aktive dhe bashkëpunuese për zgjidhjen e huave me probleme. Konkretisht, gjykohet me shumë interes që Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, bankat dhe Shoqatën Shqiptare të Bankave (AAB), të mund të konsiderojnë zhvillimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të platformës aktuale për zgjidhjen e çështjes së huave me probleme sipas Modelit “Podgorica”, pasi kjo platformë ofron një qasje më “revolucionare”, në drejtim të trajtimit më me thellësi dhe me efekte më të ndjeshme dhe pozitive në tregun e huamarrjes dhe më gjerë. Teknikisht, modeli “Podgorica”, është një qasje shumëpalëshe, që përfshin disa grupe interesi, si: bankat, bankën qendrore, qeverinë dhe biznesin që është në vështirësi. Stijepovic (2014) identifikon Ky model mbështetet në disa shtylla të rëndësishme, si:

- ristrukturimi financiar dhe operacional i biznesit, mbi baza vullnetare (pra me pëlqimin e vet biznesi dhe i bazuar në parimet e Klubit të Londrës dhe ato të INSOL (International Federation of Insolvency Professionals)), si shtrati bazal dhe aspekti kyç për jetësimin e një qasjeje të tillë, e cila rregullon kushtet për ristrukturimin e borxheve ndaj institucioneve financiare,*
- miratimi i Lex Specialis, si një marrëveshje shumëpalëshe mes qeverisë, bankës qendrore dhe bankave.* Sipas Đoković, (2013) të gjithë këto grupe interesi duhet të bëjnë lëshime, apo “sakrifica” respektive në këtë drejtim, ku: qeveria jep nxitës fiskalë (përfshirë nga pagesa të caktuara taksash që lidhen me aktivet dhe pasuritë e paluajtshme të biznesit në fjalë madje dhe subvencionim të pjesëshëm të normës së interesit të huave të ristrukturuara), banka qendrore zbaton klasa klasifikimi më të larta për këto hua që ristrukturohen dhe bankat “fshijnë” një pjesë të normës së interesit, ulin normat e interesit, si dhe të zgjasin periudhën e shlyerjes së huas,
- përpilimi i një plani të zgjeruar ristrukturimi financiar dhe operacional për bizneset e dakordësuara, që shkon përtej planit tradicional dhe individual të bankave për ristrukturim të huave dhe që ndërhyr thëllë jo vetëm në administrimin financiar të subjektit, por dhe në ridimensionimin e veprimtarisë dhe strukturës operationale të tij, kryerja e procesit të ristrukturimit krejtësisht jashtë gjykatës, si një proces i pastër ndërmjetësimi, ku një rol kyç merr dhe Shoqata e Bankave.*

Thelbi i këtij modeli (Figura 1) qëndron në mbajtjen në jetë të atyre bizneseve, që kanë probleme në shlyerjen e huave, por që mund të rifuten në biznes dhe rrjedhën normale të ripagimit të huave dhe taksave, nëse u ofrohet një qasje e ndryshme nga ajo aktuale në adresimin e huave me probleme. Đoković, (2013) pohon se, “Modeli Podgorica” synon të ofrojë, në periudhë afatgjatë, efekte pozitive për rimëkëmbjen e ekonomisë së Malit të Zi, të zvogëlojë rreziqet për stabilitetin financiar dhe të krijojë donatorë fiskalë cilësorë.

FIGURA 1: SKEMA INSTITUCIONALE E MODELIT “PODGORICA”



Burimi: Stijepović, R. (2014). Recovery and Reduction of Non-Performing Loans – Podgorica Approach, Journal of Central Banking Theory and Practice, 2014, 3, f.115.

Modeli “Podgorica” dhe aspektet pozitive për Shqipërinë

Zbatimi i Modelit “Podgorica” në rastin e Shqipërisë do të rezultonte në një zgjidhje me përfitim shumëpalësh, pra me ndikim pozitiv jo vetëm për bankat, por më gjerë, edhe për qeverinë, ekonominë dhe gjithë sistemin ekonomik dhe financiar shqiptar. Konkretisht:

- Bankat do të arkëtonin më shumë fonde në vijim, duke mos i fshirë huat nga bilanci, e për më tepër, duke paguar më pak provizione. Nga ana tjetër, një situatë e tillë do të çlironte dhe do t'i jepte një moment të ri procesit të huadhënies,
- Ekonomia do të përjetonte një shtysë shumë pozitive, duke stimuluar kështu kërkesën dhe konsumin,
- Bizneset shmangin falimentin dhe vijnë të mbeten në qarkullimin ekonomik, duke krijuar përfitime për pronarët e tyre, punësim dhe vlerë të shtuar në ekonomi, si dhe duke rritur aftësinë e tyre paguese në banka dhe gjeneruar likuiditet në ekonomi,
- Qeveria do të përfitonte më shumë tatime në të ardhmen nga biznese që vijnë të mbeten në ekonomi dhe që nuk mbyllen apo falimentojnë, si pasojë e paaftësisë paguese,
- Banka qendrore, përmbush më së miri objektivin e saj të stabilitetit financiar afatgjatë, duke shmangur në mënyrë thelbësore edhe rrezikun e likuiditetit,
- Sigurimi i efekteve zbutëse dhe minimizuese për fenomenet negative sociale, që sjellin ekzekutimet e shumtë të kolateraleve,
- Shmangia e proceseve gjyqësore të zgjatura, joefikase dhe korruptive.

Në thelb, modeli “Podgorica” mbështetet mbi të njëjtat themele si platforma aktuale e Bankës së Shqipërisë, por trajtimi më i mirë i çështjes së huave me probleme duhet të synojë drejt objektivave më ambiciozë dhe sigurimit të efekteve pozitive për sa më shumë grupe interesi.

6. Konkluzione/ Rekomandime

Huat me probleme, si një fenomen i kudondodhur në gjithë botën, sidomos pas krizës së vitit 2008, nuk po arrijnë të ulen thelbësisht edhe në Shqipëri, duke ndikuar negativisht në ecurinë e veprimtarisë bankare, por më gjerë dhe në rritjen dhe zhvillimin ekonomik.

Pavarësisht nga masat e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë për trajtimin më efikas të këtij problemi, efekti i tyre ka qenë i kufizuar, çka nxjerr në pah nevojën për konsiderimin e modeleve alternative, që dalin jashtë kuadrit tradicional të menaxhimit dhe zgjidhjes së çështjes së huave me probleme.

Nisur nga natyra e arsyeve që kushtëzuan rritjen e shpejtë të huave me probleme dhe mos uljen e këtij treguesi brenda sistemit bankar shqiptar, këshillohet që autoritetet monetare dhe financiare shqiptare të mund të rishikojnë platformën aktuale të Bankës së Shqipërisë, duke e përshtatur dhe zgjeruar atë drejt Modelit “Podgorica”, si një model alternativ jo tradicional, por eficient, i trajtimit të huave me probleme për sistemin bankar shqiptar.

Modeli “Podgorica” mbështetet mbi të njëjtat themele si platforma aktuale e Bankës së Shqipërisë, por efektet e pritshme duket se do të jenë më pozitive dhe më gjithëpërfshirëse, për sa i takon grupeve të ndryshme të interesit që mund të përfitojnë prej saj. Gjithashtu, ky model siguron mbajtjen në jetë të atyre bizneseve, që kanë probleme në shlyerjen e huave, por që mund të rifuten në biznes dhe rrjedhën normale të ripagimit të huave dhe taksave, nëse u ofrohet një qasje e ndryshme nga ajo aktuale në adresimin e huave me probleme.

Në përfundim duhet theksuar se çështja e huave me probleme nuk është një çështje thjesht bankare apo e sistemit bankar, por ajo është një çështje e rëndësishme për të gjithë ekonominë, financat publike dhe stabilitetin financiar.

Bibliografia

- Abiad, A., Dell’Ariccia, G., & Bin L. (2011). Creditless Recoveries, IMF Working Paper 11/58, Washington, March 2011.
- Banka e Shqipërisë (2011). Rregullore “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, f.8-12.
- Banka e Shqipërisë (2013). Raporti i Mbikëqyrjes Bankare 2013, f.14.
- Çeliku, E. (2014). Shiçja e huave (me probleme) – një mekanizëm që krijon vlerë të shtuar për bankën, Revista BANKIERI (AAB), nr.14. f.39-40, janar 2015.
- Đoković. N. (2013). Zgjidhja e çështjes së huave me probleme në Mal të Zi, Revista BANKIERI (AAB), nr.9, f.19-21, tetor 2013.
- Goldstein, M. & Weatherstone, D. (2001). Implications of Early Warning Models of Crisis, aper prepared for KDIC International Financial Symposium on «The Financial Crisis and Beyond», Seoul, Korea, December 11, 2001.
- IMF (2014). ALBANIA - Financial System Stability Assessment, IMF Country Report No. 14/79, March 2014.
- Impavido, G., Klingens, C.A. & Sun, Y. (2012). Non-Performing Loans and the Macroeconomy (2012). Chapter 2 of Working Group on NPLs in Central, Eastern and Southeastern Europe, March 2012.
- Murgasova, Z., Ilahi, N., Miniane, J., Scott, A., Vladkova-Hollar, I. (2015). The Western Balkans - 15 Years of Economic Transition, Regional Economic Issues - Special Report, IMF, March 2015.
- Nadège, J., & Kang. K. (2015). A Strategy for Developing a Market for Nonperforming Loans in Italy, IMF Working Paper, “Transformimi

WP/15/24.

Nazaj, S. & Meka, E. (2014). Loan management and its *ex ante* & *ex post* role in the lending proces, Journal of Academic Research in Economics, Vol.6, Nr.3, November 2014.

Polo, A. (2012). Ndryshimet në legjislacionin tatimor fiskal dhe ndikimi i tyre ne aktivitetin dhe eficiencën bankare, Revista BANKIERI (AAB), nr.5. f.13-15, tetor 2012.

Stijepović, R. (2014). Recovery and Reduction of Non-Performing Loans – Podgorica Approach, Journal of Central Banking Theory and Practice, 2014, 3, pp. 101-118, 25 July 2014.

World Bank (2013). South East Europe Regular Economic Report No.5, December 2013, p.18.

Ziu, G. (2014). Platforma e Bankës së Shqipërisë për trajtimin e huave me probleme – një qasje e re, Revista BANKIERI (AAB), nr.10. f.14-15, janar 2014.

Burime nga interneti:

www.bankofalbania.org

www.imf.org

<http://www.worldbank.org>

Kuvendi i Shqipërisë (2013). “Për projektligjin “për një shtesë në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar””, http://www.parlament.al/web/pub/kom_ligjeve_raporti_per_tatimin_mbi_te_ardhurat_16349_1_16497_1.pdf)

TREGJET E SIGURIMEVE BUJQËSORE – MËSIME NGA VENDET E ZHVILLUARA DHE EMERGJENTE PËR REALITETIN SHQIPTAR

MAGDALENA BREGASI

Pedagoge, UET, Fakulteti i Ekonomisë & Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i

Financës E-mail: magdalena.bregasi@uet.edu.al

ABSTRAKT

Tregjet e sigurimeve bujqësore kanë zhvillime të rëndësishme në mbarë botën si rezultat i influencës së shumë faktorëve. Prodhimet më të rëndësishme bujqësore janë të njohura si produktet bazë mbi të cilat janë krijuar kontrata specifike të së drejtës së shitjes apo të blerjes apo produktet derivative. Vëllimi i kontratave të tilla ka njohur rritje të forta dhe ka influencuar në rritjen e primeve të derdhura në tregjet e sigurimeve. Kjo erdhi edhe si pasojë e rritjes së vlerësimit të produkteve të sektorit dhe lidhjeve të forta zinxhir në skemat prodhuese dhe përpunuese. Tregjet e sigurimeve bujqësore janë institucione specifike që mbështesin mbrojtjen e sektorit bujqësor krahas politikave publike të zhvillimit. Në vendet e zhvilluara si edhe ato emergjente, ata kontribuojnë për të zvogëluar ndikimet e rreziqeve, të cilat i përkasin dy akseve kryesore: ndikimit të kushteve klimatike dhe ndikimit të luhatjeve të çmimeve. Nisur nga ky konstatim, fokusi i punimit bëhet analiza e evolucionit dhe situatës konkrete të tregut të sigurimeve bujqësore në vendin tonë. Ai kërkon t'ju përgjigjet pyetjeve: A funksionojnë institucionet siguruese për sektorin e bujqësisë shqiptare? A merren masa për të papriturat natyrore? Çfarë thonë shifrat e faktet lidhur me këtë problem kur sektori i bujqësisë ka qenë dhe vazhdon të mbetet jetik për ekonominë e shqiptare? Nëse ekonomia e tregut në këtë sektor ka pësuar ndryshime domethënëse institucionale, pse institucioni i sigurimit bujqësor e blegtoral ka aq pak zhvillime ose edhe mund të mos njihet nga fermerët? Sektori i sigurimeve në bujqësi në vendin tonë ka mbetur tejte i vështirë për t'u zhvilluar në kushtet kur në 25 vite të tranzicionit sektori financiar dhe bankar ka njohur evolucione të rëndësishme. Në kushtet e vërtetimit të këtij pohimi, ne do të ballafaqohemi me shembujt më të mirë jashtë vendit për të nxjerrë sfidat e së ardhmes.

Fjalë kyç: *ndryshimet institucionale, sigurimi bujqësor, institucioni i sigurimit, rreziqet bujqësore, ndryshimet klimatike.*

Hyrje

Situata e rëndë e krijuar nga përmbytjet e mëdha në jug të vendit tonë në fillim të vitit 2015 nuk la indiferent askënd. Në fakt, shoqëria humane po gjendet gjithnjë e më shumë përballë rreziqeve të katastrofave natyrore nga të katër anët e globit në ndikimin e ndryshimeve klimatike si dhe të vetë njeriut mbi natyrën. Bashkimi Europian (BE) ka pësuar si rezultat i katastrofave natyrore *mbi 80 000 të vdekur dhe mbi 95 miliardë euro humbje ekonomike vetëm mes viteve 2002 – 2012*. Në BE vlerësohet gjithashtu se *përmbytjet po bëhen një kërcënim i madh mbi shoqëritë. Tri vende ndaj katër pranojnë se epidemitë dhe kushtet e ashpra meteorologjike (stuhitë, periudhat e të ftohtit ose vapë ftohtit ose vapës së madhe, dëbora apo akulli) janë shumë të dyshimta për të ndodhur në periudha afatshkurtra* (<http://ec.europa.eu>).

Në kushtet kur efektet e rreziqeve natyrore si përmbytjet, ngricat e papritura, zjarret, etj. rëndojnë e sjellin pasoja të mëdha në sektorin bujqësor, problemi merr dimensione të shumta për t'u diskutuar dhe për t'u analizuar. Sot e para fjalë që duhet të bie ndër mend nuk duhet të jetë thjesht në formë pyetje "si duhet të na ndihmojë shteti?". Sigurisht, kur dëmet janë aq të rënda, shteti merr përgjegjësi, ashtu si edhe vetë solidariteti mes njerëzve, komunave brenda vendit apo edhe mes shteteve. Kur rreziqet marrin përmasa të mëdha, kërkohet domosdoshmërisht ndërhyrja e pushtetit publik.

Në vendet e zhvilluara si edhe ato emergjente, institucionet siguruese marrin rëndësi të veçantë për të zvogëluar ndikimet e rreziqeve, të cilat i përkasin dy akteve kryesore: ndikimit të kushteve klimatike, të cilat gjithmonë e kanë vënë njerëzimin përballë motit dhe ndikimit të luhatjeve të çmimeve, që në kushtet e globalizimit dhe të influencave të tregtisë së lirë bëjnë të krijohen lidhje edhe më të forta mes fermerëve.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Tregjet e sigurimeve bujqësore janë institucione specifike që mbështesin mbrojtjen e sektorit bujqësor krahas politikave publike të zhvillimit. Në vendet e zhvilluara si edhe ato emergjente, ata kontribuojnë për të zvogëluar ndikimet e rreziqeve, të cilat i përkasin dy akteve kryesore: ndikimit të kushteve klimatike dhe ndikimit të luhatjeve të çmimeve. Tregjet e sigurimeve bujqësore kanë zhvillime të rëndësishme në mbarë botën. Vëllimi i kontratave me bazë produktet e sektorit të bujqësisë ka njohur rritje të forta dhe ka influencuar në rritjen e primeve të derdhura në tregjet e sigurimeve si pasojë e rritjes së vlerësimit të produkteve të sektorit dhe lidhjeve të forta zinxhir në skemat prodhuese dhe përpunuese. Parë në këtë këndvështrim, ky punim është një analizë e evolucionit, situatës dhe prirjes konkrete të tregut të sigurimeve bujqësore në vendin tonë duke u ballafaquar me mësimet e nxjerra nga zhvillimet e këtij tregu në rrafshin global dhe eksperiencat më të mira.

Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Punimi kërkon t'i përgjigjet pyetjeve kërkimore vijuese: A funksionojnë institucionet siguruese për sektorin e bujqësisë shqiptare? A merren masa për të papriturat natyrore? Çfarë thonë shifrat e faktet lidhur me këtë problem kur sektori i bujqësisë ka qenë dhe vazhdon të mbetet jetik për ekonominë e shqiptare? Nëse ekonomia e tregut në këtë sektor ka pësuar ndryshime domethënëse institucionale, pse institucioni i sigurimit bujqësor e blegtoral nuk ka zhvillime apo edhe mund të mos njihet nga fermerët në vendin tonë? Ato i paraprijnë gjetjeve dhe diskutimit të tyre bazuar në hipotezën se "*tregu i sigurimeve në bujqësi në vendin tonë ka mbetur tejet i vështirë për t'u zhvilluar në kushtet kur në 25 vite të tranzicionit sektori financiar dhe bankar ka njohur evolucione të rëndësishme*".


Në realizimin e punimit ndihmon një vështrimi i hollësishëm i literaturës bashkëkohore botuar brenda dhe jashtë vendit. Evidentimi i modeleve bashkëkohore të funksionimit të tregjeve të sigurimeve dhe studimi i statistikave deskriptive vendase lidhur me problematikën mbështet gjetjet dhe diskutimin e tyre.

Sigurimet si bazë e drejtimit të rrezikut

Mbrojtja nga të papriturat, një dëshirë shumë e hershme e njerëzimit të cilës i përgjigjet siguri. Krijimi dhe funksionimi i sigurimeve si në mbrojtjen e individit dhe të ekonomisë në përgjithësi bazohet në përballimin e rreziqeve. Sektori bujqësisë paraqet specifika të njohura si sektor i quajtur "pa çati" ku faktorët natyrorë, biologjikë, klimatikë, teknologjikë dhe vendimmarrës nga njeriu hyjnë në lidhje të rëndësishme. Pasiguritë dhe ngjarjet e rastit janë gjithashtu të pranishme dhe me influencë. Për pasojë, sektori përballet me një gamë të shumëllojshme rreziqesh, shpesh me vështirësi për t'u zotëruar si ngricat, përmbytjet, thatësitrat, sëmundjet, etj. me pasoja ekonomike duke shkaktuar humbje të prodhimeve dhe të efektivitetit financiar të sipërmarrjeve deri në falimentimet e tyre. Sektori i bujqësisë ka një shumëllojshmëri aktiviteteve dhe specifikat tyre janë mjaft të ekspozuara me efektet e rreziqeve potenciale si p.sh. sektori i pemëtarisë, perimeve, blegtorisë, etj. Objekte të sigurimeve bujqësore bëhen të gjitha sendet e lëvizshme të bujqësisë (makinat dhe veglat bujqësore jo vetëlëvizëse, pajisjet e tërheqjes, plehu artificial, mjetet mbrojtëse, pajisja e bletarisë dhe produktet e tjera të ngjashme), blegtorisë (kafshët njëthundrake, gjedhët, bagëtia e imët, lepujt e butë, kosheret e bletëve, shpendët, etj.), të gjitha produktet (të korrat e drithërave, ushqimi i blegtorisë, produktet e përpunuara me origjinë bimore dhe shtazore), vera, rakia dhe produktet tjera bujqësore), serrat, vreshtat dhe pemët frutore.

Duhet theksuar gjithashtu se dëmet kanë efekt zinxhir tek siguria ushqimore e konsumatorëve. Drejtimi i rreziqeve të sektorit të bujqësisë mbetet një problem i mprehtë nëse marrim në konsideratë edhe rrezikun e ndryshimeve të çmimeve në treg si ballafaqim i kërkesë-ofertës dhe disekuilibrat marrin përmasa globale dhe sjellin efekte sociale të konsiderueshme. Institucionet ndërkombëtare, politikat rajonale dhe kombëtare lidhur me strategjitë e ndjekura për përkrahjen e sipërmarrësve të sektorit të bujqësisë kanë synuar dhe synojnë rritjen e kulturës drejtuese përballë rreziqeve dhe kanë sfida zgjedhjen e modeleve më të mira për mbrojtjen e tyre në rastin e ndodhjes së dëmeve. Figura nr. 1 paraqet skematikisht tipet me të cilat përballet fermeri apo aktori kryesor i sektorit në fjalë.

FIGURA NR. 1: RREZIQET ME TË CILAT PËRBALLET FERMERI



Burimi: Morishita, K. (2014): A Global Perspective of Agricultural Insurance, Tokio Marine Holdings Inc.

Drejtimi i rrezikut mund të konsiderohet si pjesë e pandarë e së përditshmes së fermerëve dhe funksionit ekonomik të aktiviteteve të tyre. Ata duhet të kapërcejnë pengesat e lidhura me mjetet financiare të nevojshme përballë rreziqeve. Nuk duhet lënë pa theksuar edhe masat që vetë ata duhet të marrin për t'u mbrojtur nga rreziqet. Nga sa nënvizuar, sigurimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale jo vetëm është i nevojshëm, por përbën një domosdoshmëri. Por, fermerët karakterizohen nga burime financiare të ulëta, prandaj gjetja e mekanizmave si duhet të veprojnë tregjet e sigurimeve të produkteve bujqësore dhe blegtorale merr përmasa institucionale dhe bëhet preokupim i politikëbërësve dhe politikave publike në mbështetje të zhvillimit të sektorit. Kjo situatë kërkon kuadër ligjor mbështetës, rregulla të qarta dhe skema veprimi për të gjetur instrumentet më të mirë kur burimet financiare janë të kufizuara dhe rreziqet me potenciale të konsiderueshme humbjes. Këto të fundit bëjnë më skeptike dhe të tërhequra veprimtarinë e institucioneve financiare dhe të kompanive të sigurimit në krahasim me mbulimet e sigurimeve të tjera, si p.sh. ato motorike ku gjejnë edhe fitime të mëdha.

Funksionimi i sigurimeve në bujqësi dhe mësim nga eksperiencia e huaj

Fillimisht duhet theksuar se policat e sigurimeve bujqësore dhe blegtorale janë specifike, sepse mëshirojnë specifikat e vetë sektorit dhe bëhen objekt i vlerësimit nga specialistë të fushave përkatëse. Po çfarë shpreh një policë e tillë? Në përgjithësi, sigurimi është formë e drejtimit të rrezikut e përdorur për t'u mbrojtur ndaj humbjeve të mundshme. Si kontratë e lidhur juridikisht mes palëve, konkretisht mes siguresit dhe të siguruarit, ajo realizon transferimin e rrezikut të humbjes nga personi fizik apo juridik i siguruar tek siguresi apo institucioni, i cili merr përsipër kundrejt pagesës së veprimit të sigurimit, garancinë e dëmshpërblimit pas verifikimit të dëmit. Në sektorin bujqësor ajo është shpesh njëkohësisht edhe mbrojtëse e pronësisë bujqësore dhe shtrihet nga mbrojtja e prodhimit bujqësor, blegtoral, pyjor, prodhimet në sera apo aqua kulturë. “Për çdo 1 euro të investuar në parandalimin e katastrofave, ne ekonomizojmë 4 – 7 euro në përpjekjet për t’ju përgjigjur katastrofave” Kështu shprehet ekonomikisht efekti i masave paraprake për t'u mbrojtur nga rreziqet e katastrofave të integruara në parimet e politikës europiane duke mbajtur parasysh shëndetin, vlerësimin e ndikimit në mjedis, përshtatjen me ndryshimin klimatik, ekosistemet, bujqësinë, transportet, energjinë, kërkimin dhe zhvillimin.


Tregjet e sigurimeve bujqësore kanë zhvillime të rëndësishme në mbarë botën si rezultat i influencës së shumë faktorëve ndër të cilët përmendim rritjen e kërkesës për prodhime bujqësore, nevojat për mbështetjen e sektorit të bujqësisë, politikat e zhvillimit dhe të ndikimit të konkurrencës.

Gjithashtu, prodhimet më të rëndësishme bujqësore janë të njohura si produktet bazë mbi të cilat janë krijuar kontrata specifike të së drejtës së shitjes apo të blerjes, të njohura në financë si produkte derivative apo kontrata të së ardhmes. Meqë vëllimi i kontratave të tilla ka njohur vetë rritje të forta, për pasojë kjo ka influencuar në rritjen e vëllimit të primeve të derdhura në tregjet e sigurimeve. Një faktor tjetër lidhet me zhvillimin me vetë rritjen e vlerësimit të produkteve të sektorit dhe lidhjeve të forta zinxhir në skemat prodhuese dhe përpunuese. Tregjet e sigurimeve bujqësore janë institucione specifike që mbështesin

mbrojtjen nga rreziqet. Por sektori bujqësor asnjëherë s’ka mbetur edhe pa vëzhgimin dhe influencën e politikave publike për ta mbështetur me instrumente nxitës dhe politika zhvillimi. Gjeografikisht nivelin e primeve më të mëdha e zënë SHBA dhe Kanadaja me 62%, vendet aziatike 18%, vendet europiane 17%, vendet e Amerikës Latine 2%, vendet afrikane 1% si dhe Australia dhe Zelanda e Re 1% (Iturrioz, 2009). Vetëm në Indi gjenden 28 milionë ekonomi bujqësore të siguruar !

Duhet pohuar ajo që në të gjithë literaturën financiare dhe praktikën e mbarë botës konstatohet: sipërmarrjet duhet të vetëmbrohen përballë rreziqeve, pra edhe ato natyrore. Ata duhet të kontribuojnë në institucionet e sigurimeve për të lidhur kontrata apo polica sigurimi. Megjithatë duhet evidentuar se historikisht kompanitë e sigurimeve kanë evituar sektorin e bujqësisë pikërisht nga specifikat e tij: rreziqet e sektorit janë sistemike, sepse në të shumtat e rasteve fermerët e së njëjtës zonë kultivojnë të njëjtat produkte bujqësore, por edhe jo sistemike, sepse një dëmtim specifik mund të ndodhë vetëm për një fermer p.sh. dëmtimi i magazinës së tij nga zjarri. Por nga ana tjetër, sektori bujqësor mund të karakterizohet herë-herë se ka kaluar një vit të mbarë bujqësor. Në kushte të tilla një kompani sigurimi është e kënaqur, sepse ka fitime të shumta nga primet e sigurimeve bujqësore, pa patur nevojë të paguajë dëmshpërblime. Në të kundërt, një vit i mbrapshtë bujqësor, sjell që të gjithë fermerët të dëmtohen të gjithë në të njëjtën kohë e për pasojë edhe vetë kompania e sigurimit mund të rrezikojë veten e saj, sepse nuk përballon shumën e dëmshpërblimeve në të njëjtën kohë, të njëjtën kohë si bankat që mund të falimentojnë nëse të gjithë depozituesit do të kërkonin depozitat e tyre në të njëjtën kohë, kur një pjesë e tyre është financuar në kreditim.

FIGURA NR. 2: ZBATIMI I NJË SKEME SIGURIMI



Burimi: Morishita, K. (2014): A Global Perspective of Agricultural Insurance, Tokio Marine Holdings Inc.

Ndër programet e para siguruese në eksperiencat e vendeve të përparuara dallohet krijimi Federal Crop Insurance Corporation në vitin 1938 në SHBA. Qëllimi i këtij institucioni ishte promovimi i stabilitetit ekonomik të bujqësisë me anën e sistemit të sigurimeve të konceptuar si instrument që siguronte mjetet e mëvonshme për kërkim dhe eksperiencë mbështetëse në sigurimet bujqësore.

Edhe në Kanada gjenden baza të rëndësishme të politikave të sigurimeve në bujqësi. Sipas një publikimi të OECD lidhur me praktikën e drejtimit të rrezikut në Kanada dhe politikën e sigurimeve në bujqësi theksohet se pjesëmarrësit zgjedhin prodhimin bujqësor dhe nivelin e mbulimit (përgjithësisht 70-90% të rendimentit të parashikuar) dhe duhet të sigurojnë të gjithë prodhimin. Prodhuesve kanadezë nuk ju lejohet të sigurojnë disa parcela dhe të tjerat jo, por të gjithë prodhimin, ndërsa dëmshpërblimi apo primi i sigurimit që përfitojnë varet nga disa faktorë si prodhimi bujqësor, vendi i shfrytëzimit bujqësor dhe historia e kërkesave për dëmshpërblim të fermerit që mund të jetë *bonus* ose *malus*. Llogaritja e dëmshpërblimit varet nga disa variabla si rendimenti mesatar i prodhimit të siguruar dhe kosto e prodhimit sipas formulës :

Dëmshpërblimi = (rendimenti i parashikuar x niveli i mbulimit x sipërfaqja e siguruar – prodhimi efektiv) x çmimin e sigurimit

Si dhe në vende të tjera, dëmshpërblimi jepet pas deklarimit dhe verifikimit të dëmit. Programi *Agri-protection* dhe *Agri-stabilité* mund të zgjasë dhënien e dëmshpërblimit deri në dy vite maksimalisht, por shumë më shpejt në rastet e katastrofave. Veç të tjerave autorët vënë në dukje se rreth 70 % të sipërfaqes së mbjellë dhe rreth 55% e fermerëve kanadezë janë të siguruar, vetëm për vitet 2009-10 rreth 64 milionë akër e kultivuar ka qenë e siguruar nga më shumë se 81000 fermerë kanadezë me

një shumë të përafërt me 11.9 miliardë dollarë kanadezë, ndërsa në tri vite, nga 2006-07 deri në 2008-09, dëmshpërblimet e derdhura kanë qenë rreth 1.7 miliardë dollarë kanadezë kundrejt 3 miliardë dollarë kanadezë prime të mbledhura. Në Kanada shquhet programi që përdor instrumente të reja lidhur me drejtimin e rreziqeve në sektorin e blegtorisë, *Cattle Price Insurance Program* (CPIP), në provincën e Albertës. Të siguarit zgjedhin vetë instrumentat e drejtimit të rrezikut dhe mbulimit të çmimeve duke marrë në konsideratë çmimet e tregjeve dhe kursin e këmbimit (Antón, J., Kimura, S. & Martini, R., 2011).

Aktualisht, programet në formën pilot të krijimit dhe nxitjes së mikro sigurimeve krahas mikro financës po gjejnë me shpejtësi përkrahjen në të gjitha kontinentet, sidomos në vendet ku bujqësia është jetike dhe varfëria e madhe si në vendet afrikane dhe ato aziatike. Parimi bazë i këtyre programeve është se realizimi i sigurimeve në bujqësi dhe blegtori duhet shoqëruar me zotërimin e kapaciteteve të duhura nga i siguruari për të qenë në gjendje të drejtojë rreziqet nga njëra anë si dhe me ndërtimin dhe forcimin institucional nga ana tjetër si kusht i vendosjes së kulturës siguruese.

Një promotor me traditë ndër më të hershmet në fushën e sigurimeve janë vendet e BE ku spikasin eksperiencat e Francës, Italisë, Spanjës, etj. Tabela vijuese ilustron instrumentat e përdorura nga fermerët për drejtimin e rrezikut bazuar në një anketim të rreth 1000 fermerëve zhvilluar në vitin 2008. Treguesit evidentojnë se rreth 69% të fermerëve gjermanë kanë përdorur sigurimin e korrjeve, po kështu edhe 59 përqind e fermerëve spanjollë.

TABELA NR. 1: PËRQINDJET E FERMERËVE QË PËRDORIN INSTRUMENTE TË NDRYSHME TË DREJTIMIT TË RREZIQEVE (NË PËRQINDJE)

Instrumentet	Gjermania	Hollanda	Spanja
Sigurimi i korrjeve	68.9	30.5	59.2
Sigurimi i blegtorisë	42.8	37.2	36.6
Shumëllojshmërisë	28.4	11.5	18.8
Kontrata të tregtimit	49.3	18.6	12.6
Kontrata të prodhimit	16.4	20.8	5.8
Investimet jo bujqësore	49.8	6.2	5.8
Punësimi jo bujqësor	36.8	17.7	4.7
Sigurimi dëmeve	75.1	66.8	29.8
Integrimi vertikal	7	4.4	12.6
Burime jo kreditore	31.3	38.1	36.6
Mbulimi	5	1.3	1
Rezerva financiare	61.2	22.6	22.5

Burimi: Antón, J. & S. Kimura (2011), *La gestion des risques agricoles en Espagne*, Éditions OCDE <http://dx.doi.org/10.1787/5kggh4stgtxv-fr> bazuar në Palinkas et Székely in Meussissen, M. et Van Asseldonk, M., *Income stabilization in European Agriculture*, Wageningen, Academic, 2008. Résultats d'une étude menée auprès d'environ 1 000 agriculteurs.

Aktualisht, BE mbështet shkëmbimin e praktikave më të mira të shteteve anëtare dhe ka si objektiv nxitjen e një kulture parandaluese. Me kujdes Komisioni Europian ka kristalizuar edhe akset drejtuese kryesore specifiku në katastrofat potenciale si rezultat i ndryshimeve klimatike dhe efektit serrë. Ai rekomandon vëmendje të madhe rreth problemeve të lidhura me qeverimin, planifikimin, mbajtjen e të dhënave, komunikimin, sensibilizimin ndaj rreziqeve, kërkimin dhe transferimin e teknologjisë si hallka kryesore bashkërendimi dhe koordinimi pune në rrafshin institucional dhe kooperues (<http://ec.europa.eu>).

Analiza e gjetjeve në rastin shqiptar

Diskutimi i problematikës së këtij punimi lidhet me analizën jo thjesht të shumëllojshmërisë së rreziqeve të sektorit të bujqësisë me instrumentet të drejtimit të tij, por edhe me akumulimet e tyre si rezultat i transformimeve që në periudha të ndryshme kohore i është nënshtruar vetë sektori dhe politikave të ndjekura për zhvillimin e tij. Parë në këtë fokus, sigurimet bujqësore në vendin tonë kanë evolucionin e tyre, të cilin mund ta përmbledhim në etapat vijuese:

- I. Eksperiencën embrionale para viteve të Luftës së Dytë Botërore: gjenden përpjekje të individëve prodhues dhe tregtarë


që në fundin e shek.19 dhe fillimet e shek.20 që të nënshkruajnë polica sigurimi për mallrat e tyre në lundrim. Si rezultat i një pune paraprake hulumtuese që kam bërë pranë Drejtorisë së Arkivit të Shtetit në Tiranë rezultojë fakte të njohjes së kulturës së sigurimeve për mbrojtjen e mallit gjatë lundrimit (tregtarë të Shkodrës) apo të mbrojtjes nga zjarri në Korçë. Kultura e sigurimeve erdhi nga kontaktet me shoqëri të njohura të huaja jashtë vendit por ajo mbeti embrionale dhe jo e institucionalizuar mirë. Kompanitë që kanë vepruar në vendin tonë kanë qenë kompani angleze si Lloyd's, e e pranishme që në fillimet e shek.19^{te} me filialet e saj në Durrës dhe Vlorë si dhe shoqëri italiane si “Societa Assicurazione Generale Fiume”.

Eksperiencën e modelit të centralizuar të ekonomisë pas viteve 1947 dhe deri në rënien e sistemit. Duhet të nënvizojmë se përpara viteve 90’ të gjitha ish-ndërmarrjet dhe kooperativat bujqësore kishin detyrimin e të qenit të siguruar, megjithëse bëhej fjalë për një financë tejet të centralizuar e të ndërtuar sipas modelit sovjetik edhe në fushën e sigurimeve. Nga transformimi i “Arkës së Kursimeve dhe të Sigurimeve” në vitin 1991 u krijua edhe i pari institucion sigurimi i njohur si Instituti i Sigurimeve të Shqipërisë (INSIG), 100% në pronësi të shtetit shqiptar, që do të përfaqësonte monopolin e vetëm deri më 1999 kur u themelua kompania e parë private e sigurimeve SIGMA dhe një vit më vonë SIGAL. Aktualisht tregu i sigurimeve ka përparime të dukshme në sajë të krijimit të kompanive të shumta private dhe shumëllojshmërisë së produkteve që ofrojnë (shih tabelën nr. 1).

III. Boshllëkun institucional të kulturës siguroese dhe zhvillimit të këtij tipi sigurimi gjatë periudhës së tranzicionit e deri më sot duke shtruar një emergjencë aktuale për të krijuar tregun e sigurimeve bujqësore. Në fakt, sigurimi si aktivitet në përgjithësi në vendin tonë rregullohet me Ligjin nr.52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Ligji nr.9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” i ndryshuar, pati qëllim vendosjen e parimeve dhe rregullave të përgjithshme për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit, të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime dhe mbikëqyrjen institucionale. Në kuadrin ligjor në përgjithësi mbeten nevoja evidente për përafrimin e legjislacionit me “acquis communitaires” të Bashkimit European në fushën e sigurimit.

Analiza e problemit nuk mund të jetë e plotë pa parë evolucionin e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimin e tij në sajë të reformave strukturuese dhe iniciativave sipërmarrëse. Grafiku nr 1 evidenton shpërndarjen e njësive ekonomike bujqësore në të gjithë vendin tonë ku raporti mes zonës rurale dhe urbane është shumë pranë, vetëm vitet e fundit në sajë të transformimeve të forta demografike brenda vendit, popullata në zonën rurale është pak më e lartë se ajo rurale. Për pasojë, aktivitetet e lidhura me sektorin mbeten shumë jetike për vendin. Po kështu, evolucioni i numrit të fermave dhe shumëllojshmërisë së tyre konfirmon një numër të stabilizuar me ulje të lehtë në dekadën e fundit. Por aktivitetet mbeten shpesh në nivelet e sigurimit të jetesës dhe fermat dhe aktivitetet tregtuese gjejnë më shumë evolucion vitet e fundit si rezultat i rikthimit të shumë emigrantëve dhe riinvestimit të kapitaleve të tyre në aktivitete sipërmarrëse të mirëfillta bujqësore apo agropërpunuese, agroturizmi, etj.

GRAFIKU NR. 1: SHPËRNDARJA E NJËSIVE EKONOMIKE BUJQËSORE



Burimi: Autorja, bazuar në të dhënat e CENSUS, 2012.

Tabela nr. 2 paraqet dinamikën e evolucionit të fermave bujqësore shqiptare gjatë mbi një dekadë, 2012- 2013: Ajo evidenton se pjesën më të madhe të fermave e zënë ato të kombinimit të prodhimeve bujqësore me ato blegtorale. Prodhimet bujqësore dominuese i përkasin bimëve të arave, por gjenden të përgjysmuara ato me pemëtari. Në fakt, tabela nuk evidenton sipërfaqet, sepse duhet theksuar se ndërsa numri i fermave pësuar ndryshime, kjo ka ardhur edhe si rezultat i rritjeve të lehta të sipërfaqeve të tyre si rezultat i procesit të shitjeve, blerjeve të tokës dhe përqendrimeve.

Në vendin tonë ka patur një zhvillim progresiv dhe pozitiv të serrave, të cilat janë një instrument i rëndësishëm jo thjesht për produktivitetin më të mirë duke zbutur ndikimin stinor, por ato sigurojnë një sistem mbrojtës kundër rreziqeve klimatike. Tabela nr. 3 evidenton se sipërmarrësit bujqësorë shqiptarë kanë investuar kapitale duke trefishuar sipërfaqen me serra në mbi një dekadë, por edhe ato nuk i rezistojnë dëmtimeve nga faktorët klimatikë siç treguan faktet e fillimit të vitit 2015 me dëmet nga përmytjet. Prandaj sigurimi i tyre është gjithashtu emergjent dhe duhet të jetë pjesë e biznesit dhe e kostos.

TABELA NR. 2: DINAMIKA E TIPAVE TË FERMAVE BUJQËSORE 2002 – 2013

Feramat	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Me bimë e me blegtori	349.244	357.533	351.174	340.235	328.668	331.404	298.496	305.378	294.525	299.077	301.950	305.839
Me bimë pa blegtori	37.356	37.316	25.784	33.340	39.870	37.508	57.676	48.108	55.622	54.086	48.966	49.597
Me blegtori pa bimë	710	2.382	423	692	0	457	472	-	-	-	-	-
Me arash	381.334	384.851	375.021	372.019	366.068	364.917	352.766	350.067	344.928	348.704	342.974	347.392
Me pemëtari	334.517	350.961	141.705	137.244	149.636	148.660	144.578	151.784	155.986	170.846	159.778	161.836
Me tokë djerr	140.595	126.999	103.505	88.405	123.510	113.384	115.014	105.133	91.251	97.137	83.241	84.313
Gjithsej	387.930	394.849	377.427	374.517	368.997	369.598	357.027	353.486	350.654	353.341	350.916	

Burimi: ish-Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, 2013.

TABELA NR. 3: SIPËRFAQJA E PERIMEVE NË SERRA (NË HA)

	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Serra ngrohje	30	21	17	13	13	19	28	35	48	62	75	54	57	68	40
me xham	30	17	15	13	12	14	18	11	19	15	18	14	16	14	14
me plasmas	-	4	2	-1	5	10	24	29	47	57	40	41	54	26	
Serra diellore	279	395	445	424	496	533	632	615	627	621	629	656	771	812	900
me xham	98	112	114	85	70	88	79	81	65	75	65	61	80	78	69
me plasmas	181	283	331	339	426	445	553	534	562	546	564	595	691	734	831
Serra gjithsej	309	417	462	478	509	552	660	650	675	683	704	710	828	880	940

Burimi: ish-Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave. 2013.


Një e dhënë është e sigurt dhe e njohur për të madh e të vogël në vendin tonë: sigurimi i makinave, po kështu kjo e fundit, është e njohur për fermerët dhe agropërpunuesit. Por, gjendet një evolucionin aq i ngadaltë dhe pa influencë financiare dhe kontraktuese të “sigurimeve bujqësore dhe blegtorale” në bujqësinë aktuale shqiptare. Ky problem, sa interesant dhe i rëndësishëm, ka mbetur teorik për t’u prekur në temat e financave rurale, sepse të dhënat statistikore në vendin tonë nuk gjendeshin të publikuara dhe transparente. Sa herë që kam trajtuar temën specifike “sigurimi në bujqësi dhe blegtori” me studentët në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT) ku kam qenë lektore mbi dy dekada akademike, nuk rrija pa ju treguar studentëve të ilustruar një policë sigurimi me objekt “sigurimi nga breshëri” që UBT kishte lidhur me institucionin e sigurimeve INSIG për sigurimin e bazës së vet prodhuese. Për më tepër, kjo policë sigurimi i kishte bazat e saj legale në kushtet e përgjithshme të kontratës së sigurimit nga breshëri, miratuar nga ish-Ministria e Financave dhe e Ekonomisë me

urdhri e saj nr. 1 datë 15 korrik 1993. Por, ishte e vështirë të gjeja një policë të kontraktuar nga një fermer apo agrobiznes!

Nëse tregu i sigurimeve në përgjithësi është rritur në mënyrë të qëndrueshme në vendin tonë, ai i sigurimeve në bujqësi dhe blegtori lë për të dëshiruar. Në fakt, sigurimet bujqësore lidhen ngushtë me financimet bujqësore. Pikërisht, meqë aksi “sigurime bujqësore dhe blegtorale” kërkon jo thjesht ndërgjegjësimit të sipërmarrësve të sektorit, por edhe një nivel të caktuar të shëndetit financiar dhe të konsolidimit të tyre, gjenden zhvillime të dobëta të tregut të sigurimeve bujqësore dhe blegtorale në vendin tonë e për pasojë nuk gjenden statistika lidhur me gjendjen edhe me evolucionin e tij.

Në portalin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (<http://www.amf.gov.al>), që mbikëqyr tregun e sigurimeve konstatojmë një panoramë të aktorëve kryesorë sigurues jo-jetës, grafiku vijuese nr 1. Totali i portofolit të sigurimeve për vitin e kaluar 2014 evidenton se sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës zënë rreth 14%, ndërsa përgjegjësitë motorike ndaj palëve të treta zënë peshën më të madhe, rreth 66%, por është e pamundur të njihemi me ndonjë statistikë për sigurimet bujqësore. Po kështu, në portofolin “sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës” gjatë vitit 2014, vihet re një rritje prej 23.38% e volumit të primeve të shkruara bruto të këtij portofoli dhe një rritje me 0.64% e numrit të kontratave të sigurimit, krahasuar me vitin 2013, por nëse vërejmë nivelin e dëmeve të paguara për sigurimin nga zjarri dhe forcat e natyrës, ai është vetëm 1,76%. Tabela nr. 4 evidenton primet e shkruara bruto në përqindje në sigurimin “zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtimet e tjera në prone” për vitet 2013 dhe 2014.

GRAFIKU NR. 2: NDARJA E TREGUT - SIGURIMI I JO-JETËS NË VENDIN TONË, VITI 2014



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, 2015, <http://www.amf.gov.al>

Duke qenë se sektori i bujqësisë është sektor shumë i vështirë dhe ende në vendin tonë fermat tregtare nuk janë mbizotëruese dhe të konsoliduara, sigurimi bujqësor ka mbetur dhe mbetet problematik, por jo i pambuluar me oferta.

Do të veçoja paketën e ofruar për të gjithë fermerët dhe investitorët që punojnë në fushën e bujqësisë nga kompania e sigurimeve SIGAL-Unica Group Austria, ku evidentohet qëllimi i këtij sigurimi: mbrojtja e biznesin bujqësor dhe atij blegtoral nga zjarri, vjedhja, rreziqet natyrore, sëmundjet, dëmtimet dhe helmimet aksidentale.

Kjo kompani siguron polica si ndërtesa, makina dhe makineri bujqësore, investimet në bujqësi, prodhimin bujqësor, serrat, linja dhe teknologji prodhimi blegtoral, kafshët bujqësore dhe kafshë me vlera të veçanta përdorimi, shpendët dhe bazën ushqimore. Tarifat e sigurimit variojnë nga 0,15% deri në 6,0% të shumës së siguruar, në varësi të objektit si dhe llojeve të rreziqeve që do të sigurohen.

TABELA NR. 4: PRIMET E SHKRUARA BRUTO NË SIGURIMIN “ZJARRI, FORCAT E NATYRËS DHE DËMTIMET E TJERA NË PRONË”

Shoqëria e sigurimit	Pjesa ndaj totalit (në %)	
	2013	2014
Sigal Uniq Group Austria	52,63	44,51
Intersig Vienna Insurance Group	6,91	14,39
Albsig	6,84	7,96
Sigma Vienna Insurance Group	8,38	6,01
Interbanian Vienna Insurance Group	11,33	5,92
Insig	4,21	5,74
Atlantik	2,54	5,65
Eurosig	5,00	5,40
Ansig	2,16	2,82
Sigma Interbanian Vienna Insurance Group	-	1,59
Totali	100,00	100,00

Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, 2015, <http://www.amf.gov.al>

FIGURA NR. 3: SHEMBULL I SIGURIMIT TË PRONËS

Kontrata e sigurimit ofron mbrojtje financiare për objektet e marra në sigurim sipas klasave të rrezikut të zgjedhura nga aplikanti për sigurim.

Objekti i sigurimit: Prona e palëvizshme (ndërtesa) si dhe të gjitha makineritë dhe pajisjet të cilat ndodhen brenda saj

Rreziqet e sigurimit:

Zjarri, rrufeja, eksplozioni, rënia e avionëve apo pjesëve të tyre; Katastrofat natyrore (tërmeti, përmbytja, stuhia, breshëri); Vjedhja.

Periudha e sigurimit: Një vit nga data që bihet dakord midis palëve.

Shuma e sigurimit: Vlera e ndërtesës dhe e pajisjeve; (sipas deklaratave të klientit)

Tarifat: Mjaft konkurruese, dhe të ndryshueshme në vartësi të llojit të objektit që do të sigurohet, kushteve të tij dhe rreziqeve të zgjedhura.

Burimi: <http://www.sivig.al>

Gjetjet e mësipërme tregojnë se zhvillimet e bujqësisë shqiptare nuk janë mbështetur si duhet nga sigurimet dhe vetë siguruesit nuk kanë gjetur leva bashkëpunimi me aktorët bujqësore, prandaj politikëbërësit duhet të punojnë në ndërtimin e strategjive dhe gjetjen e mënyrave se si të krijohet akses për fermerët dhe agropërpunuesit me qëllim që të marrin pjesë në sigurimet bujqësore dhe blegtorale. Studimi i praktikave më të mira, lidhjet e partneritete privat-publik, projektet pilot, forcimi i lidhjeve mes aktorëve të interesuar në fushën e sigurimeve krahasimuese të instrumentave financues dhe kreditues lënë shumë hapësira të nevojshme për t'u shfrytëzuar.

Konkluzione / Rekomandime

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë dhe mbështetja e tij kërkon zhvillimin dhe mbështetjen nga tregu i sigurimeve në bujqësi. Analiza e rreziqeve potenciale të sektorit shtron emergjencën e ndërtimit dhe konsolidimit të këtij të fundit, sepse ai nuk ka gjetur vëmendjen e duhur dhe përkrahje institucionale gjatë 25 vite tranzicion. Megjithatë sektori ka probleme të mëdha si pasojë e fragmentarizmit të tokës së punueshme dhe nga ana tjetër gjenden zhvillime pozitive për sa i përket politikave subvencionuese nga vitet 2010, duhet të gjenden mënyrat për të bërë reale mekanizmat siguruese. Kompanitë e sigurimeve, si aktorë të rëndësishëm të konsoliduar në veprimtarinë e sistemit financiar në vendin tonë, kanë ofruar sigurimet për pronën, por pak prej tyre paketa speciale për sigurimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale dhe në realitet nuk gjenden rezultate të këtyre paketave. Nuk gjenden të paktën projekte pilot në mikro sigurime kur ndërkohë ka patur zhvillime të rëndësishme të mikro financës. Subvencionet e viteve të fundit duhet të jenë të shoqëruara me nxitjen e kulturës së sigurimit nga vetë sipërmarrësit e sektorit. Gjithashtu, politikëbërësit duhet të njohin më mire kapacitetet dhe mundësitë financiare të sipërmarrësve në këtë sektor dhe të mbështesin me emergjencë kulturën e sigurimeve në sektorin e bujqësisë. Për këtë, duhet vlerësuar nevoja e plotësimit të kuadrit rregullator në nivel kombëtar sidomos edhe për të përballuar emergjenca të lidhura me ndryshimet klimaterike dhe efektet e ngrohjes globale duke krijuar fonde garancie. Po kështu ata duhet domosdoshmërisht të njohin dhe studiojnë modelet dhe eksperiencat më të mira për të përshtatur dhe ndihmuar aktorët e interesuar për zbatimin dhe mbështetjen e skemave të sigurimit përballë rreziqeve që karakterizojnë sektorin e bujqësisë. Mekanizmat fiskalë dhe krijimi i një strategjie për ndërtimin e skemave të sigurimit bujqësor bazuar në inovacionet aktuale globale, në modelimin e rrezikut si dhe në karakteristikat e zhvillimit të bujqësisë shqiptare mbetet një rekomandim që politikëbërësit duhet ta marrin në konsideratë. Kjo do t'i shërbente zhvillimit dhe konsolidimit të tregut të sigurimeve bujqësore dhe blegtorale duke plotësuar panoramën e tregut financiar dhe bankar të vendit tonë. Nga ana tjetër, nuk duhet neglizhuar edhe puna e vetë kompanive të sigurimeve për një sensibilizim të shënjestruar të aktorëve në sektorin e bujqësisë duke i informuar dhe edukuar më mirë ata dhe për të nxitur kështu vullnetarizimin për pjesëmarrjen e tyre në skemat siguruese të ofruara.

Falënderim

Për hulumtimet lidhur me punimin, specifíkisht për historinë e sigurimeve para viteve 40' të shekullit të kaluar, do të dëshiroja të shpreh një falënderim për Prof. Dr. Nevila Nika për mendimet e shkëmbyera si dhe punonjësit e Drejtorisë së Arkivit të Shtetit, Tiranë që më mundësuan të shfletoj dokumente kërkimore pranë institucionit të tyre.

Bibliografia

- Antón, J., S. Kimura et R. Martini (2011), La gestion des risques agricoles au Canada, Éditions OCDE <http://dx.doi.org/10.1787/5kghq53d1v6h-fr>
- Antón, J. & S. Kimura (2011), La gestion des risques agricoles en Espagne, Éditions OCDE <http://dx.doi.org/10.1787/5kghq4stgtxv-fr>
- AMF Albania, Raport vjetor 2013, http://www.amf.gov.al/pdf/publikime2/raport/amf/344_RV%202013%20al.pdf
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, 2015, <http://www.amf.gov.al>
- Fletorja zyrtare e R.SH. (2014): Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 709, datë 29.10.2014 Për miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Numri:169.
- INSTAT, Të dhëna paraprake të regjistrimit të bujqësisë, CENSUS, 2012
- Iturrioz, R., 2009: Agricultural Insurance, The World Bank, primer series on insurance issue 12.
- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, Vjetari statistikor 2013.
- Morishita, K. (2014). A Global Perspective of Agricultural Insurance, Tokio Marine Holdings Inc. Retrieved from <http://www.greenclimateproject.org>
- Petraj I. (2011): Insurance Market in Albania, http://www.dukagjinicollege.eu/libri3/439-444_Petraj_Ina.pdf
- Willet, A.H., The economic theory of risk and insurance, <https://www.casact.org/pubs/forum/91wforum/91wf469.pdf>

Burime interneti

- http://sigal.com.al/home/02_business/008_sigurimet_e_bujqesise_dhe_blegtorise
- <http://www.sivig.al>
- <http://ec.europa.eu>

MATJA E PERFORMANCËS SË BANKAVE TREGTARE NË SHQIPËRI NËPËRMJET ANALIZËS SË RAPORTEVE FINANCIARE

ERMELA KRIPA

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti Ekonomisë dhe IT, Financë
E-mail: ermela.kripa@uet.edu.al

ARBI AGALLIU

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti Ekonomisë dhe IT, Financë
E-mail: arbi.agalliu@uet.edu.al

ABSTRAKT

Në literaturë ekzistojnë shumë studime shkencore dhe empirike mbi analizën e performancës së bankave nëpërmjet raporteve financiare. Edhe në Shqipëri ka punime të cilat janë kryer rreth cilësisë së kredisë dhe faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që e ndikojnë atë. Ky punim ka për qëllim vërtetimin dhe studimin e performancës së bankave tregtare në Shqipëri gjatë periudhës 2005-2014. Punim ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë llogariten disa prej indikatorëve më të përdorur të përfitueshmërisë, likuiditeti dhe aftësisë shlyese për të gjitha bankat tregtare në Shqipëri nga viti 2005- 2014. Në pjesën e dytë të punimit janë përzgjedhur merret si rast studimor Banka Kombëtare tregtare si një ndër bankat më të mëdha në Shqipëri. Për të matur përfitueshmërinë, likuiditetin si dhe performance e cilësisë së kredisë për këtë bankë dhe për të gjitha bankat e tjera janë përdorur disa raporte financiare. Ky studim arrin në konkluzionin e përgjithshëm se pas periudhës së krizës, pas vitit 2008 vihet re një ulje ose përkeqësim i performancës si dhe cilësisë së kredisë së bankave në tregun bankar shqiptar. Duke qenë se ekzistojnë dy qasje kryesore të matjes së performancës së bankave, një e bazuar në kontabilitet dhe tjetra ekonometrike, ne zgjedhëm të bënim një studim të performancës përdorur analizën e raporteve financiare.

Fjalë kyç: *Sistemi Bankar Shqiptar, Performancë, Likuiditet, Cilësi Kredie, Indikatorë Financiarë.*

1. Hyrje

Bankat tregtare janë ndër institucionet më të rëndësishme financiare në të gjithë botën, për këtë arsye studimi i tyre ka një rëndësi të veçantë.

Bankat tregtare luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të çdo vendi. Pa bankat ndoshta shumë vende nuk do të ishin aq të zhvilluara sa janë tani. Megjithatë roli i bankave tregtare dhe rëndësia e tyre është në varësi të sistemit politik, social dhe ekonomik të vendit. Kështu për disa vende bankat luajnë rol thelbësor në zhvillimin e ekonomisë së tyre, ndërsa në disa vende të tjera roli i tyre është më i vakët.

Performanca e biznesit është një çështje me rëndësi të madhe për studiuesit, pasi ajo ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në vendimet e aktorëve që janë të lidhur me një biznes të caktuar, si pronarët, menaxherët, punonjësit, konsumatorët, etj. Firmat me performancë të lartë gjenerojnë fitime si për vetë biznesin, ashtu edhe për shoqërinë në tërësi, duke ofruar mundësi të ndryshme punësimi.

Performanca financiare lidhet me cilësinë e aktivitetit financiar të institucionit, dhe qëllimi i saj është të masë se sa janë përmbushur objektivat financiare të saj. Nëpërmjet performancës financiare firmat mund të masin rezultatet e politikave, strategjive dhe veprimtarisë së tyre në terma monetare, ndaj studimi i kësaj teme paraqitet me një rëndësi të madhe studimore.

Përgjatë kohës autorë të ndryshëm janë munduar të japin përkufizime të ndryshme në lidhje me performancën financiare të një institucioni të caktuar. Kështu sipas Moullin (2003), performanca nënkupton mënyrën se si është menaxhuar firma dhe se si ky menaxhim ka ndikuar tek pronari dhe konsumatorët, në vlerën që ata kanë marrë.

Ndërsa Aktan dhe Bulut (2008), e përkufizojnë performancën financiare si “aftësinë e firmës për të gjeneruar burime të reja prej operacioneve ditore, përgjatë një periudhe kohore të caktuar.”

Darsono dhe Ashari (2005), argumentojnë se performanca financiare vlerëson gjendjen e burimeve të firmës dhe pasqyrat financiare janë tregues të potencialit të burimeve të firmës për të gjeneruar të ardhura.

Studimet e mëparshme kanë një rëndësi të madh në realizimin e një teme të re. Është shumë e rëndësishme të kuptohet se çfarë është thënë në të kaluarën në lidhje me temën e studiuar dhe cilat kanë qenë rezultatet e arritura. Në këtë mënyrë mund të arrihet të bëhen dhe krahasime për të parë nëse studimi ka sjelle një risi në këtë fushë, apo ka pohuar ose mohuar atë që teoria ka thënë në të kaluarën. Për këtë arsye më poshtë janë paraqitur disa nga teoritë kryesore në lidhje me përfitueshmërinë e bankave tregtare dhe se si ajo ka ndikuar në performancën e këtyre institucioneve.

Në lidhje me performancën e bankave tregtare janë kryer studime të shumta, nga autorë të ndryshëm në të gjithë botën. Ata kanë arritur të shpjegojnë se si ka ndryshuar performanca e bankave të marra në studim përgjatë viteve, cilët kanë qenë faktorët që kanë ndikuar në performancën e tyre, si dhe çfarë e ka karakterizuar secilin vend, cilët kanë qenë specifikat e secilit prej tyre. Këto studime kanë arritur në përfundime të ndryshme në lidhje me faktorët që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare.

Jensen dhe Meckling (1976) arritën në përfundimin se struktura e pronësisë dhe qeverisja e korporatave, kanë ndikim të rëndësishëm në performancën e bankave tregtare. Studimet e tyre shpjegojnë arsyen se pse drejtuesit e institucioneve zgjedhin aktivitete të ndryshme për të rritur performancën e institucionit që ata drejtojnë, duke u bazuar në strukturën e kapitalit të tyre.

Autoriteti Mbikëqyrës i bankave tregtare të çdo vendi, ka si qëllim të minimizojë rrezikun moral, që mund të hasin këto institucione përgjatë veprimtarisë së tyre. Për këto arsye Bankat Qendrore kanë nxjerrë një rregullore, në bazë të të cilës ato i kërkojnë bankave tregtare raporte minimale të kapitalit. Por sipas Saunders dhe Cornett (2008), barra rregullatore neto ndikon negativisht në performancën e bankave tregtare.

Autorë të shumtë arritën në përfundimin se edhe struktura e bilancit ka ndikim të madh mbi përfitueshmërinë e bankave tregtare. Raporti i kapitalit aksioner me asetet totale, si një ndër treguesit më të rëndësishëm të bilancit, mori një vëmendje të veçantë nga këta autorë.

Megjithatë kjo teori hasi dhe kundërshtime. Kështu Modigliani dhe Miller (1958) argumentuan se nuk ekziston asnjë lidhje ndërmjet strukturës së kapitalit, pra nëse firma financohet me kapitalin e vet apo me borxh, me vlerën e tregut të saj. Gjithashtu edhe teoria e risk-kthimit sugjeron se rritja e riskut, duke rritur përdorimin e levës financiare dhe ulur raportin ndërmjet kapitalit dhe asetëve, do të sjellë kthim më të lartë të pritshëm për çdo risk shtesë të marrë, duke rritur kështu edhe përfitueshmërinë e bankave tregtare.

Autorë të ndryshëm si Short (1979), Hu (2002), Goddard (2004), Smirlock (1985) etj, argumentojnë se madhësia e një banke është e lidhur ngushtë me mjaftueshmërinë e kapitalit dhe nga ana tjetër, mjaftueshmëria e kapitalit është e lidhur me përfitueshmërinë e bankës. Sipas tyre bankat e mëdha kanë tendencë të rrisin kapitalin e tyre, duke rritur kështu edhe përfitueshmërinë. Megjithatë studiues të tjerë kanë arritur në përfundimin se madhësia e një banke ndikon pozitivisht në përfitueshmërinë e saj, deri në një nivel të caktuar. Më pas për arsye burokratike, efekti i madhësisë do të ndikojë negativisht në përfitueshmërinë e bankës.

Studime të kryera në vende të ndryshme të Europës arritën në përfundimin se bankat e mirëkapitalizuara kanë më pak mundësi falimentimi dhe kanë performancë më të lartë. Në këtë përfundim arriti dhe Dietrich dhe Wanzenried (2010), gjatë studimit të tyre për bankat tregtare në Zvicër.

Treguesit e likuiditetit si dhe të kredisë, janë përcaktuar si faktorë specifikë bankarë, që ndikojnë në përfitueshmërinë e këtyre institucioneve. Menaxhimi i tyre është i një rëndësie të madhe pasi ndikon drejtpërsëdrejti në menaxhimin e risqeve të ndryshme bankare.

Sipas Bourke (1989), duke qenë se kreditë mbartin një rrezik më të lartë se investimet e tjera, atëherë edhe kthimi i pritur do të jetë edhe më i lartë. Si pasojë marrëdhënia ndërmjet treguesve të likuiditetit dhe performancës do të jetë pozitive.

Gjithashtu Cooper (2003) shpjegon se ndryshimet në riskun e kredisë do të sjellin ndryshime edhe në portofolin e kredive të bankave tregtare, duke ndikuar dhe në përfitueshmërinë e tyre. Sipas tij, një rritje në riskun e kredisë, do të sillte ulje të përfitueshmërisë të bankave tregtare, si pasojë edhe e performancës së tyre.

Në të njëjtin përfundim arrihen dhe Miller e Noulas (1997). Sipas tyre institucionet financiare të ekspozuara ndaj një risku të madh kredie dhe sa më i lartë të jetë akumulimi i huave të pakthyera, aq me të vogla do të jenë dhe kthimet. Si pasojë edhe përfitueshmëria do të jetë e ulët. Edhe menaxhimi i riskut të likuiditetit është i një rëndësie shumë të madhe për veprimtarinë e bankave tregtare. Ka patur studime të ndryshme, që kanë vërtetuar se ekziston një lidhje ndërmjet likuiditetit dhe përfitueshmërisë së bankave tregtare. Kështu Yuqi Li (2008), në studimin e tij arriti në përfundimin se likuiditeti ka efekt të konsiderueshëm pozitiv ose negativ në përfitueshmërinë e bankave tregtare. Molyneux dhe Thorton (1992) gjejnë një lidhje negative ndërmjet nivelit të likuiditetit dhe përfitueshmërisë së bankave. Pra sipas tij, një rritje e nivelit të likuiditetit sjell ulje të përfitueshmërisë dhe performancës së bankave tregtare. Nga ana tjetër Bourke gjen një lidhje pozitive ndërmjet likuiditetit dhe përfitueshmërisë, pasi sipas tij rritja e nivelit të likuiditetit sjell rritjen e përfitueshmërisë dhe performancës së bankave tregtare.

Gjithashtu studimet kanë treguar se edhe vendimet menaxheriale kanë ndikim të madh në performancën e bankave tregtare. Kështu drejtuesit e niveleve të larta duhet t'i kushtojnë shumë rëndësi vendimeve dhe politikave menaxheriale që ata ndërmarrin. Kryesisht këto vendime kanë të bëjnë me menaxhimin e asetëve dhe detyrimeve të bankës, me menaxhimin e shpenzimeve, me vendimet mbi përqendrimin e portofolit të kredive, etj.

Jensen dhe Meckling (1976) vënë në dukje dhe marrëdhëniet midis pronarëve dhe menaxherëve, si çelës suksesi. Sipas tyre pronari duhet të "forcojë kontrollin" mbi menaxherin, në mënyrë që vendimet e menaxherit të ndikojnë në rritjen e performancës së institucionit për të cilin ai punon.

Literatura argumenton se një ulje e shpenzimeve operative do të rrisë efikasitetin e bankave tregtare, duke ndikuar në rritjen e përfitueshmërisë dhe si pasojë dhe performancës së tyre. Megjithatë më poshtë do të shihet se jo gjithmonë ky arsytim është i vërtetë.

Wall (1995) arriti në përfundimin se menaxhimi i detyrimeve dhe asetëve të bilancit të një banke ka ndikim të rëndësishëm në nivelin e përfitueshmërisë së saj. Ndërsa Bourke (1989) arriti në përfundimin se shpenzimet e personelit kishin ndikim negativ në ROA-n e bankave, duke ndikuar kështu në uljen e përfitueshmërisë së bankave. Por Molyneux dhe Forbs (1995) e hodhi poshtë këtë teori, duke gjetur një lidhje pozitive ndërmjet shpenzimeve të personelit dhe përfitueshmërisë së bankave tregtare. Shumë studime kanë arritur në përfundimin se analiza e raporteve financiare është mënyra më e mirë për të matur performancën e bankave tregtare. Gopinathan (2009) në studimin e tij arriti në përfundimin se analiza e raporteve financiare nxjerr në pah mundësitë e firmës për të investuar, mat performancën financiare të firmës dhe analizon bazat e saj. Gjithashtu vihet re se shumë autorë në matjen e performancës së bankave tregtare, por edhe të institucioneve të tjera financiare, përdorin analizën e raporteve financiare.

Kryesisht studiuesit përfitueshmërinë e bankave tregtare e masin nëpërmjet raporteve të performancës si ROE (kthimi nga kapitali i vet) dhe ROA (kthimi nga aktivet). Sipas një hulumtimi të realizuar në Spanjë nga Trujillo (2013), për bankat tregtare të cilat ishin të mirëkapitalizuara, u arrit në përfundimin se bankat tregtare kishin një performancë më të lartë kur përfitueshmëria matej nëpërmjet ROA. Kjo vinte si pasojë e rritjes së kapitalit në raport me asetet totale, pra ROE ulej për shkak të levës financiare.

2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Ky punim ka për qëllim vrojtimin dhe studimin e performancës së bankave tregtare në Shqipëri gjatë periudhës 2005-2014. Punim ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë llogariten disa prej indikatorëve kryesorë të përfitueshmërisë dhe likuiditetit për të gjitha bankat tregtare në Shqipëri nga viti 2005- 2014. Në pjesën e dytë të punimit merret një rast studimor për të vërtetuar hipotezën dhe për të arritur objektivin e punimit. Ky studim mund të japë disa sinjale të rëndësishme për sjelljen e përfitueshmërisë së disa bankave gjatë kësaj periudhe, duke identifikuar natyrisht dhe shkaqet që kanë çuar në këto ndryshime.

Për të matur përfitueshmërinë, likuiditetin si dhe performancën e cilësisë së kredisë janë përdorur disa raporte financiare. Ky studim arrin në konkluzionin e përgjithshëm se pas periudhës së krizës, pas vitit 2008 vihet re një ulje ose përkeqësim i performancës së bankave në tregun bankar shqiptar.

3. Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Gjithnjë e më tepër bankat janë duke u përfshirë në transaksione sa më komplekse, duke u ekspozuar akoma më tepër me lloje dhe niveleve të ndryshme risku. Vlen të përmendet fakti që risku më i rëndësishëm që kërkon më shumë kujdes për t'u mbajtur nën kontroll është pikërisht risku i kreditit dhe cilësisë së kreditimit. Ky punim përdor një qasje përshkruese të raporteve financiare për të matur, përshkruar dhe analizuar performancën e bankave tregtare në Shqipëri në periudhën 2005-2015. Për të vërtetuar hipotezën e punimit do të merret edhe një rast studimor, ku do të analizohen 6 variabla për njërin nga bankat më të mëdha në Shqipëri siç është Banka Kombëtare Tregtare.

Pyetjet kërkimore të ngritura në këtë punim janë:

A ka ndikuar kriza globale në përkeqësimin e indikatorëve të performancës në sistemin bankar shqiptar?
Nëse cilësia e kreditimit është e mirë dhe në nivele të kënaqshme, niveli i përfitueshmërisë a do të jetë relativisht më i lartë?

Hipoteza e ngritur në këtë punim është: Gjatë periudhës 2005- 2009 performanca e bankave ka qenë më e mirë se gjatë periudhës së pas krizës financiare.

Një ndër arsytet që na shtynë në zgjedhjen e realizimit të analizës së performancës së bankave nëpërmjet raporteve financiare qëndron në metodologjinë e thjeshtë të përdorur, si dhe në azhurnimin e të dhënave pasi nga punimet më të hershme ato shkojnë deri në vitin 2012. Të dhënat e përdorura janë marrë nga Shoqata Shqiptare e Bankave për 5 indikatorët e parë 9 ata të përfitueshmërisë dhe të likuiditetit si dhe Banka e Shqipërisë për indikatorin e cilësisë së kredisë. Janë marrë të dhënat për 16 bankat të cilat operojnë në tregun bankar Shqiptar. Kufizimet e punimit kanë të bëjnë me të dhënat, pasi ato janë marrë nga Shoqata Shqiptare e Bankave por, janë të pa audituara (të llogaritura sipas IFRS-ve, por të pa udituara). Një tjetër kufizim ka të bëjë edhe me përzgjedhjen e variabileve. Për arsye se për disa banka nuk kishim informacion nga viti 2005 nuk u përdorën disa variabile të rëndësishëm të përfitueshmërisë siç është ai i kosto/të ardhura si dhe ai i mjaftueshmërisë së kapitalit, pasi duhej llogaritur për secilën bankë për të gjitha vitet. Për këtë arsye për secilën prej bankave janë llogaritur 6 indikatorët e marrë në studim. Duhet theksuar se njëra prej bankave të marra në studim (Banka Amerikane) është blerë nga banka Intesa Sanpaolo dhe të dhënat për këtë bankë shkojnë deri në vitin deri në vitin 2008. Për matjen e performancës së bankave mund të përdoren variabile të shumtë. Por në studimin tonë kemi marrë në konsideratë këto 6 variabile duke ju referuar dy punimeve të autorëve Kumbirai, M., Webb, R. (2010) si dhe Adam, M (2014).

Variabilet e përfitueshmërisë

- 0 **Kthimi mbi Kapitalin e vet (ROE)** = fitimi neto/kapitalin aksioner. ROE është një ndër indikatorët më të rëndësishëm të përfitueshmërisë dhe potencialit të rritjes së bankës. ai është norma e kthimit të aksionerëve apo përqindja e kthimit për çdo lekë aksione të investuara në bankë.
- 1 **Kthimi mbi Asetet (ROA)** = fitimi neto/asetet totale e cila tregon aftësinë e menaxhimit për të rritur depozitat me një kosto të arsyeshme dhe ti investojnë ato në investime fitim prurëse. ky indikator tregon se sa shumë fitim neto po gjenerohet për çdo lekë të aseteve. Sa më e lartë ROA, aq më përfitueshmëri të lartë ka banka.
- 2 **Kthimi mbi depozitat (ROD)** = fitimi neto/totalin e depozitave. Ky raport tregon përqindjen e kthimit për çdo lekë të depozituar nga klientët. pra, e thënë ndryshe ajo tregon efikasitetin e Bankës në konvertimin e depozitave në fitime neto. (Rosly and Bankar, 2003, p. 1257).

Variabilet e Likuiditetit

- 0 **Huatë Neto mbi Totalin e Aseteve (NLTA)** = Hua neto/asete totale. NLTA mat përqindjen e aseteve të cilat mbahen në formën e kredive. Sa më I lartë ky raport, aq më pak likuide është banka.
- 1 **Huatë Neto mbi Depozitat Totale (NLDST)** = Hua Neto/Totali i Depozitave. Ky raport tregon përqindjen e totalit të depozitave të bllokuara në asetet jo likuide. Një normë e lartë e tij tregon likuiditet të ulët.

Variabilet e cilësisë së kredisë

- 0 **Rezerva e humbjeve të kredive mbi kreditë Bruto (LRGL)** = Rezerva e humbjeve të kredive/kredi bruto. Ky raport tregon përqindjen e totalit të portofolit të hequr mënjanë por jo të përdorur. Ai është një rezervë për humbjet e shprehur si përqindje e totalit të kredive.

Analizë, interpretim të dhënash

Për të vërtetuar hipotezën u morën në analizë 6 indikatorët e sipërpërmendur. Secili prej tyre u përlogarit për periudhën 2005 – 2014. Në pjesën e parë të analizës po paraqesim ecurinë e indikatorëve të performancës si dhe një analizë të shkurtër për periudhën e marrë në studim. Për më tepër shihni tabelën dhe grafikun nr. 1.


TABELA NR. 1, INDIKATORËT E PËRFITUESHMËRISË

Vitet	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
ROE	10.71%	7.03%	10.71%	6.86%	5.51%	5.29%	6.29%	3.11%	2.03%	3.78%
ROA	0.82%	-0.06%	0.81%	0.43%	0.62%	0.58%	0.51%	-0.01%	-0.23%	0.58%
ROD	-2.67%	-0.69%	1.10%	0.32%	1.03%	0.98%	0.05%	-1.20%	-1.22%	1.39%

Burimi: AAB, grafik i vetë autorëve.

Këto banka kanë qenë 17 në total, por pas disa proceseve shkrirjesh dhe blerjesh, egzistojnë 16 banka. Duhet theksuar se në punim janë marrë në konsideratë edhe ato bank atë cilat sot nuk ekzistojnë më siç është Banka Amerikane, e cila është blerë në vitin 2008 banka nga Intesa Sanpaolo.

Nga tabela e mësipërme vihet re se tre indikatorët e performancës kanë pasur një trend rënës nga viti 2006 deri në vitin 2009, për të pësuar një rritje nga viti 2009 për ROA dhe 2010 për ROE dhe vihet re një përkeqësim deri në 2013 për të pasur një rritje të lehtë në 2014. Për sa i përket indikatorit të ecurisë së depozitave, nga viti 2005 deri në vitin 2007 vihet re një rritje e tij, ndërkohe një zvogëlim nga periudha 2008 deri në vitin 2013. Megjithatë vihet re se në vitin 2008 kemi një rënie në vlerat 0.32% dhe më pas një rritje në vlerat 1,09% në vitin 2009, kjo për arsye se sistemi bankar shqiptar ka pësuar një rënie të lehtë të depozitave vetëm në tremujorin e fundit të vitit 2008. Dy indikatorët e tjerë ROE dhe ROA, kanë pasur të njëjtin trend zbritës siç vihet re nga figura 1. Rënia bëhet më e theksuar deri në vitin 2008 për tu stabilizuar në periudhën 2008 – 2011 dhe për të verifikuar një rritje pas vitit 2013. Kjo rënie në indikatorët e ROE dhe ROA shpjegohet me rritjen e nivelit të kredive të këqija gjatë kësaj periudhe të cilën e kemi të analizuar në tabelën nr. 3. Vlerat me të larta të ROE dhe ROA vihen re në vitin 2005 dhe 2007 me vlera përkatësisht 10.71% dhe 0.82%, për të pasur një tjetër rritje në vitin 2011 me 6.29% për ROE dhe 0.62% për ROA në vitin 2009 për tu përkeqësuar më vonë.



Burimi: AAB, grafik i vetë autorëve.


Për sa i përket indikatorëve të likuiditetit nuk vërehen ndryshime të mëdha. Këta dy indikatorë masin aftësinë e bankës për të shlyer detyrimet financiare në periudhë afatshkurtër të cilat janë shumë të rëndësishme për të treguar ecurinë dhe vazhdimësinë e institucioneve bankare. Figura 2 tregon trendet e indikatorëve të performancës, raport I dhënë nga vlerat mesatare të huave neto përmbi asetet totale si dhe raportit mestar të huave neto përmbi totalin e depozitave.

TABELA NR. 2: INDIKATORËT E LIKUIDITETIT

Vitet	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
NL/TA	29.93%	31.46%	43.16%	50.41%	52.40%	50.06%	53.76%	49.50%	44.22%	45.10%
NL/TD	44.11%	41.84%	63.86%	83.95%	82.58%	72.89%	79.13%	68.64%	58.67%	58.25%

Burimi: AAB, grafik i vetë autorëve.

FIGURA NR.2: INDIKATORËT E LIKUIDITETIT



Burimi: AAB, grafik i vetë autorëve.

Ajo që vihet re nga figura 2, është se NL/TA ka pasur një rritje të lehtë nga viti 2007 deri në 2009 për të pësuar një rënie nga 52,40% në 2009 në 50.06% në vitin 2010. Pas vitit 2011 vihet re një rënie në këtë indikator prej përveç vitit 2011 dhe një rënie më të lehtë në vitin 2013 - 2014.

Në përgjithësinë një raport NLTA i lartë mund të tregojë mundësinë e problemeve të likuiditetit për bankat në një treg të shtrenguar të kredive që përballen me tërheqje të larta të depozitave apo të papritura. Gjithsesi, rritja e NLTA për të gjitha

bankat nuk shfaqin ndonjë problem likuiditeti pas vitit 2008 për aq kohë sa bankat Shqiptare mund të aksesojnë rezervat e Cashi-t të cilat ato i mbajnë si kërkesë minimale të kërkuara me rezervat e bankës. Në vitin 2008 – 2009 vihet re një rritje e këtij raporti kjo shpjegohet me rritjen e kredive të reja dhe pas vitit 2012 vihet re një zvogëlim i raportit për shkak të zvogëlimit të kredive të reja në sistem.

Indikatori tjetër i likuiditetit LA/DT ka pasur një rënie të lehtë pas vitit 2011 e cila tregon një rënie të likuiditetit për bankat. Në vitet 2008 – 2009 vihen re dhe vlerat më të larta të këtij treguesi me vlerat përkatësisht 83.95% si dhe 82.58%. Megjithatë mund të thuhet që edhe pas viteve 2007 – 2008 sistemi bankar shqiptar ka pasur një nivel të mirë të likuiditetit. Nuk ka pasur ndryshime të theksuara. Çështjet e qëndrueshmërisë financiare janë të lidhura më me rritje në indikatorin e përfitueshmërisë, për aq kohë sa vlera të ulëta të likuiditetit tregojnë vlera më të larta të aseteve dhe totali i depozitave janë të angazhuara në hua. Në kushte normale një rritje e shpejtë e huave çon në kthime më të larat dhe rrezik më të lartë. Gjithsesi, Saunders dhe Cornett (2006) argumentojnë se një rritje më e shpejtë e aseteve (huave) se sa e depozitave është tregues që banka po përdor fondet e marra hua në mënyrë të tepruar.

Cilësia e kredisë lidhet me ekzaminimin e riskut të shoqëruar me një portofol të aseteve. Figura 3 tregon një trend në rritje të këtij indikator nga viti 2007 i cili ka pasur një nivel në përqindje në vlerën 1.04% për tu rritur çdo vit deri në vitin 2013 me një përqindje prej 8.85 %. Pra ky indikator ka pësuar një rritje prej 7.81 % nga viti 2007 deri në vitin 2013. Gjithsesi, nga viti 2009 deri në vitin 2013 shifrat tregojnë një rritje të përkeqësimit të cilësisë së kredisë. Ky tregues regjistroi një rritje prej 1.91% nga 2008 që ishte në nivelin 2.20% në 2009 në nivelin 4.11%. Një përmirësim i lehtë pas vitit 2010 erdhi për shkak të rritjes së vazhdueshme të huave të klientëve edhe pse verifikohet edhe një rritje të kredive me probleme, të cilat vazhdojnë me një trend zbritës.

TABELA NR. 3: INDIKATORI I CILËSISË SË KREDISË

Vitet	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
LLR/GL	1.04%	2.20%	4.11%	5.33%	5.46%	7.05%	8.85%

Burimi: AAB, grafik i vetë autorëve.

FIGURA NR. 3: INDIKATORI I CILËSISË SË KREDISË



Burimi: AAB, grafik i vetë autorëve.

Për sa i përket indikatorëve të likuiditetit edhe për bakën BKT nuk vërehen ndryshime të mëdha. Këta dy indikatorë masin aftësinë e bankës për të shlyer detyrimet financiare në periudhë afatshkurtër të cilat janë shumë të rëndësishme për të treguar ecurinë dhe vazhdimësinë e institucioneve bankare. Tabela 4 tregon trendet e indikatorëve të performancës dhe atyre të likuiditetit për periudhën 2005 – 2014 për Bankën Kombëtare Tregtare. Edhe rasti i kësaj banke mbështet analizën e bërë më sipër për të gjitha bankat në sistemin bankar.

TABELA 4: INDIKATORËT PËR BKT

Vitet	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
NL/TA	21.40%	26.68%	28.23%	33.14%	36.88%	36.67%	41.73%	36.55%	33.12%	33.12%
NL/TD	22.92%	28.87%	30.09%	36.84%	42.35%	42.08%	49.20%	45.32%	41.14%	41.14%
ROD	0.38%	1.42%	1.56%	1.62%	1.10%	1.91%	1.69%	1.66%	1.83%	1.83%
ROE	6.33%	25.41%	28.22%	21.16%	13.56%	21.07%	19.30%	16.99%	18.29%	18.29%
ROA	0.35%	1.31%	1.47%	1.46%	0.96%	1.66%	1.43%	1.34%	1.47%	1.47%

Burimi: AAB, grafik i vetë autorëve.

Nga analiza e variabileve të mësipërme arrin në përfundimin se hipoteza vërtetohet. Indikatorët e performancës dhe ai i cilësisë së kredisë janë përkeqësuar pas viti 2008. Kjo tregon se rritja e kredive me probleme ka ndikuar në përkeqësimin e indikatorëve të performancës ROE dhe ROA.

Përfundime

Rezultatet tregojnë se gjatë periudhës 2006 – 2008 performanca e bankave në terma të përfitueshmërisë, likuiditeti si dhe cilësisë së riskut ka qenë më e mirë. Pas vitit 2008 indikatorët e përfitueshmërisë përkeqësohen, kjo mund të justifikohet me rritjen e shpenzimeve operative si dhe uljen e të ardhurave për shkak të krizës financiare. Për më tepër për shkak të përkeqësimit të aftësisë paguese, pas krizës ka bërë që bankat të rrisin LLR/GL pas vitit 2010.

Po t'i referohemi të dhënave të rezultatit neto pas tatimit, ROE dhe ROA, tregojnë për një tendencë në rënie të tyre duke treguar për një performancë gjithnjë e më të ulët të sistemit tone bankar për periudhën e marrë në analizë. Ritmet e rritjes së kredive me probleme konsiderohen shqetësuese për sistemin bankar në kushtet kur kemi frenim të dhënies së kredive të reja. Kreditë me probleme ndaj kredive totale në nivel banke gjatë viteve 2005-2014 shfaqin përgjithësisht një tendencë në rritje të tyre.

Rritja e kredisë me probleme në terma neto, është shoqëruar me rritjen e peshës së tyre ndaj treguesve të kapitalit. Për rrjedhojë, aftësia e sistemit për të mbuluar me kapital rregullator humbjet potenciale nga kredia rezultojnë të jetë reduktuar dukshëm përgjatë këtyre viteve.

Norma e ulët e këtij treguesi për Shqipërinë është e lidhur me strukturën e thjeshtë të burimeve të bankave tona, ku përgjithësisht dominojnë depozitat, kurse borxhi i marrë qoftë nga bankat brenda vendit apo jashtë vendit është i kufizuar.

Rezultatet e marra dhe studimi i kryer tregojnë së përgjithësisht sistemi ynë bankar për periudhën 2005-2014 është karakterizuar nga shumë luhatje për sa i përket performancës, menaxhimit efektiv të risqeve si edhe problematika në lidhje me kreditë e pakthyer. Problematika këto që kanë çuar në ulje të ndjeshme të indekseve të përfitueshmërisë.

Bibliografia

- A. Trujillo, "What Determines the Profitability of Banks? Evidence from Spain," *Accounting & Finance*, Vol. 53, Issue 2, pp. 561-586, 2013.
- A. Dietrich, and G. Wanzenried, "Determinants of bank profitability before and during the crisis: Evidence from Switzerland", *Journal of International Financial Markets, Institutions and Money*, 2, 307-327, 2011.
- A. Saunders's, and M. Cornett's, *Financial Markets & Institutions* 4th ed., McGraw-Hill/Irwin Series in Finance, Insurance and Real Estate, 2008.
- A. Samad, "Bahrain Commercial Bank's Performance during 1994-2001" *Credit and Financial Management Review* 10(1), (2004). F. Modigliani, and M. H. Miller, "The cost of Capital, corporation finance and the theory of investment," *American Economic Review*, 48, 261-297, 1958.
- H. Cooper, Editorial. *Psychological Bulletin*, 129, 3-9, 2003.
- I. Ghazouani. B. Ameer, and M. M. Sonia, "Explanatory Factors of Bank Performance in Tunisia: A Panel Model Approach, *Global Journal of Management and Business Research Finance*, Volume 13 Issue 5 Version 1.0, Year 2013.
- M. Adam, "Evaluating the financial performance of banks using financial ratios- a case study of erbil bank for investment and finance," *European Journal of Accounting Auditing and Finance Research*, Vol.2, No.2, pp. 156-170, August 2014.
- M.C. Jensen, and W. H. Meckling, "Theory of the Firm: Managerial Behavior, Agency Costs and Capital Structure," *Journal of Financial Economics*, vol. 2, fq. 305 – 360, 1976.
- M. Kumbirai, and R. Webb, "A financial Ratio Analysis of Commercial Bank Performance in South Africa", *African Review of Economics and Finance*, Vol. 2, No. 1, Dec 2010.
- P. Bourke, "Concentration and other determinants of bank profitability in Europe, North America and Australia", *Journal of Banking & Finance* 13, 65-79, (1989).
- P. Molyneux, and J. Thornton, "Determinants of European Bank Profitability: A Note", *Journal of Banking and Finance* 16 (6), 1173- 1178, (1992).
- P. Molyneux, and W. Forbes, "Market structure and performance in European Banking", *Applied Economics*, 27, 155-159, 1995.
- Q. Kupina, and D. Salko, "Banking system performance on actual stage of economic development (a comparison analysis of banking systems of albania and kosovo)," MCSER Publishing, Rome-Italy, Vol 6 No 2 March 2015.
- S. Miller, and A. Noulas, "Portfolio Mix and Large-Bank Profitability in the USA", *Applied Economics*, 29, 505-512, 1997.
- T. Gopinathan, "Financial ratio analysis for performance check" <http://suite101.com/article/financial-ratio-analysis-for-performancecheck-a109025>, 2009.
- T. D. Wall, and P. R. Jackson, *New manufacturing initiatives and shop floor work design*. In A. 1995.
- Yuqi. Li, "Determinants of Banks' Profitability and its Implication on Risk Management Practices: Panel Evidence from the UK in the Period 1999-2006", Dissertation, University of Nottingham, 2008.

MENAXHIMI I RREZIQEVE FINANCIARE KUSHT PËR RRITJEN E PËRFITUESHMËRISË NË BANKAT TREGTARE NË SHQIPËRI

PROF. DR ANILDA BOZDO

SOKOL NDOKA, DOKT

ABSTRAKT

Ky studim ka në fokus analizën e faktorëve që ndikojnë shkallën e përfitueshmërisë së sistemit bankar në Shqipëri. Punimi shkon përtej evidentimit të faktorëve deri në analizën e menaxhimit të tyre. Gjatë këtij studimi ngrihen në vëmendje katër variabla të rëndësishëm në terma të përfitueshmërisë, të tilla si rreziku i normës së interesit, rreziku i kthimit të kredisë, rreziku i kursit të këmbimit dhe rreziku operacional. Nëpërmjet analizës numerike do të studiohet efekti sasior i secilit prej këtyre variabëlve në indikatorët e përfitueshmërisë së bankave tregtare në Shqipëri. Në vijim të studimit pritet që rreziku i normës së interesit dhe rreziku i kthimit të kredisë të kenë peshën më të madhe për sa i përket shkallës së përfitueshmërisë së sistemit bankar në Shqipëri, përkundërt dy variabëlve të tjera të pavarura, rrezikut të kursit të këmbimit dhe rrezikut operacional. Punimi ngrihet mbi bazën e një studimi empirik me të dhëna sekondare, të karakterit cilësor dhe sasior. Ky studim ka një kontribut të konsiderueshëm në kuadër të identifikimit të faktorëve që ndikojnë përfitueshmërinë e sistemit bankar në Shqipëri si dhe nxjerrjen e një raporti apo zgjidhje shkencore për menaxhimin e rreziqeve financiare në mënyre sa më eficiente. Rekomandimet e derivuara nga ky punim do t'i shërbejnë kërkuesve të rinj të fushës akademike dhe profesionale. Po ashtu punimi hap një shteg të ri diskutimi mbi instrumentet e menaxhimit të rrezikut në sistemin bankar Shqiptar. Gjatë konferencës do të identifikohen dhe do të prezantohen variabla më të rëndësishëm të pavarur që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare Shqiptare.

Fjalë kyç: *përfitueshmëri, rreziku i normës së interesit, rreziku i kursit të këmbimit, rreziku operacional, rreziku i kthimit të kredisë.*

I. HYRJE

Rreziku është një ndër faktorët kyç në biznesin e sotëm. Në çdo vendim që merret brenda një biznesi është rëndësishme që ekzekutivët dhe menaxherët të bëjnë balancimin e duhur ndërmjet rrezikut dhe kthimit. Që një kompani të jetë e suksesshme është e rëndësishme të bëhet një menaxhim efektiv i rrezikut të biznesit. Menaxhimi i rreziqeve në sistemin bankar merr një rëndësi të veçantë, ku për mbrojtjen ndaj dështimit të sistemit bankar dhe ekonomisë janë përgjegjës rregullatorët ekonomike dhe financiar. Bankat ashtu si bizneset e tjera janë të ekspozuara ndaj rreziqeve të ndryshme. Rreziqet kryesore të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në përfitueshmërinë sistemit bankar janë: rreziku i kredisë, rreziku i normave të interesit, rreziku operacional, rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i vendit, rreziku i teknologjisë, rreziku i zërave jashtë bilancit etj..

Në mënyrë që bankat t'i shmangen dështimit dhe falimentimit të tyre duhet t'i menaxhojnë me kujdes të gjitha rreziqet financiare. Është e rëndësishme që këto rreziqe të menaxhohen me sukses, pasi në qoftë se një bankë do të perceptohet në një pozicion të dobët financiar, depozituesit do t'i tërhiqin të gjitha fondet e tyre dhe nga ana tjetër banka nuk do të ishte në gjendje të shiste as letrat me vlerë të borxhit. E gjitha kjo do të përkeqësonte më tepër situatën financiare të kësaj banke.

Kriza financiare e viteve 2007-2009 filloi si një krizë e "subprime" në SH.B.A. Zotërimi i një shtëpie nga kredimarrësit me të ardhura të ulëta ka qenë për SH.B.A. një qëllim më vete. Tregjet "subprime" u krijuan për të përmbushur këtë qëllim dhe gjithashtu për të krijuar para për krijuesit e tyre. Çështja kryesore me të cilën duhet të përballëshin bankat ishte rreziku i lartë që shoqëronte këta kredimarrës. Kredimarrësit "subprime" janë më të rrezikshëm se kredimarrësit e cilësuar "prime". Kështu edhe nëse ky rrezik vlerësohej nga bankierët, duhej të ekzistonin standarde të ulëta pranimit për t'i siguruar këtij segmenti kredimarrësish mundësinë e përfitimit të kredive. Më specifikisht, huamarrësit "subprime" karakterizohen nga një sërë elementesh duke i bërë ata të vështirë për bankat.

Qëllimi dhe objektivat e Studimit

Identifikimi i faktorëve të rrezikut që ndikojnë që përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri.

Përpilimi i një raporti i cili tregon gjendjen aktuale të përfitueshmërisë së bankave të nivelit të dytë në Shqipëri në lidhje me rreziqet financiare.

Nxjerrja e një rekomandimi apo zgjidhje shkencore në lidhje me menaxhimin e rreziqeve financiare në mënyrë sa me eficientë duke rritur përfitueshmërinë e bankave.

Hipotezat e punimit

Rreziku i kredisë ndër të gjitha rreziqet e tjera si rreziku i normës së interesit, i rrezikut të kursit të këmbimit dhe i rreziku operacional është faktori kryesor që ka ndikuar në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri.

Pyetja Kërkimore

Si kanë ndikuar rreziqet e normës së interesit, kursit të këmbimit, rreziku operacional në rezultatin financiar të bankave?

A kanë mbajtur bankat pozicione të hapura valutore, Gap-et e riçimitit në nivele kritike?

Si kanë ndikuar kreditë me probleme në rezultatin financiar të bankave dhe çfarë peshe kanë pasur ato në këtë rezultat?

Metodologjia e Punimit

Qasje cilësore (të dhëna cilësore), Qasje sasimore (të dhëna sasimore).

Paraqitja ekonometrike

$$Y = B_0 + B_1X_1 + B_2X_2 + B_3X_3 + B_4X_4$$

Y – Përfitueshmëria e bankës

B₀ - shmangja e lejuar

X₁ - Rreziku i kredisë,

X₂ - Rreziku i normave të interesit.

X₃ - Rreziku operacional,

X₄ - Rreziku i kursit të këmbimit

II. Përkufizimi i rrezikut të kredisë

Rreziku kryesor me të cilën përballen bankat është rreziku i kredisë i cili përkufizohet si: "Potenciali që një debitor do të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të tij (principal, interesa, komisione), në kohë apo në përputhje të plotë sipas termave

të kontraktuara të kredisë”¹. Bankave ju kërkohet me ligj të mirëmbajnë llogarinë e Rezervave të Humbjes së Kredisë² për të mbuluar këto kredi. Rreziku i kredisë lind nga potenciali që një debitori ose i mungon dëshira për të paguar detyrimin e tij ose aftësia e tij për të paguar detyrimin është përkeqësuar duke rezultuar në një humbje ekonomike për bankën. Humbja mund të jetë e gjithë shuma e kredisë ose shuma pjesore e kredisë dhënë kredimarrësit.

Humbja rezulton nga një reduktim i vlerës së portofolit si rezultat i përkeqësimit aktual apo të perceptuar të cilësisë. Rreziku real nga krediti është devijimi i performancës së portofolit nga vlera e pritur. Rreziku i kredisë është edhe rreziku i përkeqësimit të pozicionit financiar të emetuesit të letrës me vlerë (aksionet, obligacionet). Rreziku i kredisë vjen nga marrëveshjet e kredisë së një banke me individët, korporatat, institucionet financiare apo shtetit. Për pjesën më të madhe të bankave kreditë janë burimi më i madh dhe më i dukshëm i rrezikut të kredisë, sidoqoftë rreziku i kredisë rrjedh nga aktivitete të tjera bankare: nga zërat në bilanc dhe nga zërat jashtë bilancit³. Bankat po përballen me rrezikun e kredisë në instrumente të ndryshëm financiare duke përfshirë: Pranimet bankare, transaksionet ndërbankare, transaksionet e kurseve të këmbimit, kontratat “Future”, swaps, opsionet

Rreziku i kredisë mund të kategorizohet në bazë të arsyeve të dështimit. P.sh dështimi mund të jetë në sajë të shtetit në të cilin banka ka ekspozim apo si rezultat i problemeve në kryerjen dhe përfundimin e transaksioneve. Jo domosdoshmërisht rreziku i kredisë ndodh i vetëm. Të njëjtat burime që ekspozojnë institucionin ndaj rrezikut të kredisë, mund ta ekspozojnë gjithashtu dhe ndaj rreziqeve të tjera, p.sh një portofol i keq shfaq problem dhe me likuiditetin. Banka duhet të konsiderojë lidhjen ndërmjet rrezikut të kredisë dhe rreziqeve të tjera. Banka duhet të identifikojë, të matë, të monitorojë dhe të kontrollojë rrezikun e kredisë që lidhet me aktivitetet e saj (për të gjithë portofolin, transaksionet dhe kreditë individuale), si dhe të caktojë mjaftueshmërinë e kapitalit kundrejt këtij rreziku dhe nëse është mjaftueshmërisht i kompensuar.

Objektivi kryesor i Menaxhimit të Rrezikut të Kredisë është të maksimizojë normën e kthimit të rregulluar nga rreziku duke mbajtur një nivel të pranueshëm të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë. Rreziku duhet të menaxhohet në nivel të “Debitorëve të Lidhur”⁴.

Komponentët e menaxhimit të rrezikut të kredisë

Menaxhimi efektiv i rrezikut të kredisë është thelbësore për suksesin afatgjatë për çdo organizëm bankar. Ekspozimi ndaj këtij rreziku vazhdon të jetë burimi i problemeve në bankat në mbarë botën, mbikëqyrësit e tyre duhet të jenë në gjendje të nxjerrin leksione të vlefshme nga eksperiencia e shkuar. Pavarësisht se praktikata e menaxhimit të rrezikut të kredisë mund të ndryshojnë midis bankave, në varësi të natyrës, kompleksitetit të aktiviteteve të kredisë etj. struktura e menaxhimit të rrezikut të kredisë do të jetë e ngjashme. Struktura e menaxhimit të rrezikut të kredisë mund të grupohet në këto komponentë kryesorë: 1- *Bordi dhe menaxhimi i lartë*, 2-*Struktura organizative*, 3- *Sistemet dhe procedurat për identifikimin, pranimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin e rreziqeve*.

Bordi dhe menaxhimi i lartë

Është përgjegjësia e bordit të bankës të aprovojë strategjitë dhe politikat kryesore në lidhje me rrezikun e kreditit dhe menaxhimin e tij, e cila duhet të bazohet në strategjinë bazë të bankës. Strategjia duhet të rishikohet nga bordi, e preferueshme një herë në vit. Strategjitë dhe politikat duhet të:

Përshkruajnë tolerancën e përgjithshme të bankës ndaj rrezikut të kreditit.

Sigurojnë që ekspozimi i përgjithshëm i rrezikut të kredisë mbahet në nivele të kujdesshme dhe në përputhje me kapitalin.

Të sigurojnë që menaxhimi i lartë si dhe individët përgjegjës për menaxhimin e rrezikut të kredisë zotërojnë aftësitë dhe njohuritë për të kryer suksesshëm funksionet e menaxhimit të rrezikut.

Qëllimi primar i strategjisë së kredisë së bankës është të përcaktojë dëshirën për rrezik të bankës. Pasi përcaktohet niveli i pranimit të rrezikut banka zhvillon plane për të optimizuar kthimin duke mbajtur rrezikun e kreditit brenda niveleve të paracaktuar. Strategjia e rrezikut të kredisë duhet të shpjegojë:

Planet e bankës për të dhënë kredi bazuar në segmente të klientëve të ndryshëm, produktet, sektorët e ekonomisë, vendndodhjen gjeografike, monedhën dhe afatet e kredive.

Tregun e synuar, nivelin e preferuar të diversifikimit dhe përqendrimit.

Strategjinë e çmimeve.

¹ Orfea Odhuci, Advanced Bank Management 2009

² Loan Loss Reserve

³ On and off balance sheet

Connected obligor: Dy ose më shumë individë apo njësi ligjore formojnë një riks të vetëm 1) ku njeri ka kontroll mbi tjetrin në mënyrë direkte ose indirekte, ose 2) janë të ndërlidhur në mënyrë të tillë që vështirësitë financiare të njërit do të ketë ndikojnë tek gjithë të tjerët në vështirësi të pagesave të detyrimeve.

Strategjia duhet të marrë në konsideratë në mënyrë të vazhdueshme ciklet e ekonomisë së vendit dhe ti ndryshojë në përputhje me përbërjen dhe cilësinë e portofolit të kredisë. Nga ana tjetër strategjia duhet të jetë e qëndrueshme në terma afatgjata.

Menaxhimi i lartë krijon dhe zhvillon politikat dhe procedurat për administrimin e kredive dhe merr aprovimin për to nga bordi i drejtorëve dhe është përgjegjës për implementimin efektiv të këtyre. Politikat dhe procedurat duhet të jenë të qarta dhe të komunikohen në të gjitha nivelet hierarkike si dhe shërbejnë si guidë për stafin mbi tipat e kredidhënies duke përfshirë korporatat, SME, konsumatorët, agrobiznesin etj.

Struktura organizative

Struktura organizative duhet të jetë në përputhje me madhësinë e bankës, kompleksitetin dhe diversifikimit të aktiviteteve të saj. Struktura mbështet ekzekutimin e duhur të menaxhimit të rrezikut të kredisë dhe proceset e kontrollit.

Çdo bankë, krijon **Komitetin e Menaxhimit të Rrezikut të Kredisë** që është përgjegjës për implementimin e politikave dhe procedurave të aprovuara nga bordi, krijimin e niveleve të pranueshme të rrezikut të kreditit që përballet banka. Monitoron rrezikun e kredisë, rekomandon bordin për politika të qarta mbi standardet, vendos përgjegjësitë dhe fuqitë e niveleve aprovuese mbi ekspozimet e kredisë, standardet për kolaterale, mekanizmat e rishikimit të kredive, përqendrimin e rrezikut, monitorimin dhe vlerësimin e rrezikut, çmimet e kredive, provigjionet, rregullat dhe përputhshmërinë me ligjet.

Bankat duhet të krijojnë **Departamentin e Menaxhimit të Rrezikut të Kredisë** i cili siguron që rreziku i ndërmarrë është brenda kufijve të krijuara nga Komiteti i Menaxhimit të rrezikut të kredisë, siguron që linja e biznesit është në përputhje me parametrat e rrezikut. Janë përgjegjës për sigurimin e provigjioneve të mjaftueshme.

Sistemet dhe procedurat

Origjinimi i kredisë

Bankat duhet të operojnë brenda kritereve të mirë përcaktuara për kreditë e reja dhe ato ekzistuese. Kreditë duhet të jepen në përputhje me strategjinë dhe brenda tregjeve të synuara. Banka duhet të sigurohet që kredia është përdorur sipas qëllimit të financimit të kredimarrësit. Nuk duhet të mbështetet vetëm tek kolaterali për dhënie të kredisë, por fokusi primar duhet të jetë aftësia për të paguar dhe reputacioni i klientit në treg. Banka mund të reduktojë rrezikun nëpërmjet diversifikimit (kredi për biznese të industrive të ndryshme ose kredimarrësve me vendndodhje të ndryshme), por nuk mund të eliminohet plotësisht sepse një pjesë e rrezikut rezulton nga rreziku sistematik. Rreziku i kredisë reduktohet edhe nëpërmjet analizave të kujdesshme të kredisë, analizës së rrezikut, kërkimi i kolateralit për të mbuluar kredinë, financimit të klientëve ekzistues për të shmangur zgjedhjet negative.

Vendosja e limiteve

Një element i rëndësishëm në menaxhimin e rrezikut është krijimi i limiteve të ekspozimit për një kredimarrës dhe për grupin e klientëve të lidhur. Madhësia e limiteve duhet të bazohet në forcën e kredisë së kredimarrësit, kushtet ekonomike dhe toleranca ndaj rrezikut. Limite vendosen për produkte, aktivitete të ndryshme, për industri specifike, sektorë të ekonomisë, apo për rajone gjeografike për të shmangur përqendrimin e rrezikut.

Administrimi i kredisë

Ndër funksionet e administrimit të kredisë janë plotësimi i dokumentacionit në përputhje me termat e aprovimit, disbursimi i kredisë, monitorimi i kredisë, shlyerja e kredisë, mirëmbajtja e dosjeve, ruajtja në kasaforta të dokumenteve të garancisë dhe kolateralit.

Matja e rrezikut të kredisë

Matja e rrezikut të kredisë është shumë e rëndësishme në menaxhimin e tij. Shumica e falimentimeve të bankave kanë ardhur si rezultat i dështimit të portofolit të kredisë. Bankat duhet të krijojnë një strukturë vlerësimi të kredisë për të gjitha tipat e aktiviteteve. Vlerësimi duhet të përfshijë **Rrezikun e biznesit** (karakteristikat e industrisë, pozicionin konkurrues etj.), **Rrezikun Financiar** (kushtet financiare, përfitueshmërinë, strukturën e kapitalit, etj.).

Vlerësimi i rrezikut të brendshëm

Vlerësimi i rrezikut të kredisë është një përmbledhje e treguesve të një ekspozimi kredie individuale ndaj bankës. Një sistem vlerësimi i brendshëm i kategorizon të gjitha kreditë në klasa të ndryshme bazuar në treguesit e cilësisë së kredisë. Një vlerësim i mirë strukturuar i kredisë shërben si mjet i rëndësishëm për të monitoruar dhe kontrolluar rrezikun e kredive individuale, portofolin e kredisë së bankës, afatet dhe çmimet e kredisë, frekuenca e monitorimit, analiza e përkeqësimit të kredive dhe llogaritjen e saktë të provigjioneve të ardhshme të kredive. Disa tregues kryesorë që matin cilësinë e një kredie janë: a) Pozicioni financiar dhe kushtet e biznesit, b) Analiza e llogarisë, sidomos për klientët ekzistues, c) Vlerësimi i kolateralit. *Po cilat ekspozime duhet të vlerësohen?* Idealisht të gjitha ekspozimeve duhet tu caktohet një vlerësim rreziku. Por është shumë e kushtueshme dhe e pamundur për bankat për ta ndjekur. Vendimi për të vlerësuar kredi të caktuara mund të

bazohet në faktorë si p.sh. shuma e ekspozimit apo linja e biznesit. Bankat përdorin modelet e vlerësimit me pikë (scoring) për kreditë konsumatore/retail.

Monitorimi dhe kontrolli i Rrezikut të kredisë

Monitorimi i rrezikut të kredisë i referohet monitorimit të vazhdueshëm të kredive individuale, duke përfshirë ekspozimet jashtë bilancit (Off- Balance sheet) të debitorëve si dhe gjithë portofolin e kredisë të bankës. Krijimi i një sistemi monitorimi kredie eficient dhe efektiv do të ndihmonte menaxhimin e lartë të monitoronte cilësinë e total portofolit të kredisë dhe trendit të tij. Politikat sigurojnë informacion në lidhje me persona përgjegjës, frekuencën e monitorimit, ekzaminimin periodik të kolateralit, identifikimi i kredive të përkeqësuar. **Auditi i brendshëm** vepron në mënyrë të pavarur dhe siguron që udhëzuesi i menaxhimit të rrezikut të kreditit është subjekt i rishikimeve të plota dhe efektive. Auditi i brendshëm e siguron **komitetin e Auditit** që kontrollet e brendshme dhe praktikatat e rrezikut të kreditit janë të duhurat dhe të mjaftueshme për tipin dhe kompleksitetin e aktiviteteve rrezik marrëse.

Rishikimi i rrezikut

Qëllimi është të vlerësojë procesin e administrimit të kredisë, vlerësimin e saktë të kredive dhe cilësinë e total portofolit të kredisë.

Menaxhimi i kredive problematike

Banka duhet të ketë politikë rreziku të qartë se si duhet të menaxhojë kreditë problematike.

Komiteti i Bazelit


Komiteti i Bazelit ka identifikuar fushat në të cilat bankat duhet të sigurojnë transparencë të plotë dhe korrekte dhe ato janë: Praktikatat dhe politikat e kontabilitetit, Menaxhimi i rrezikut të kredisë, Cilësia e kredisë, Fitimet. Monitoron bankat për transparencën e rrezikut të kredisë. Bazel II ka vendosur rregulla se sa duhet të jetë kapitali i institucioneve financiare për të mbuluar humbjet potenciale. Për matjen e rrezikut të kredisë janë propozuar dy opsione. E para është mënyra tradicionale e standardizuar, e dyta është baza e vlerësimit të brendshëm, IBR që do të sigurojë një strukturë të vetme nëpërmjet së cilës komponentët e rrezikut do të përkthehen në kërkesa minimale të kapitalit.

Kriza e rrezikut të kredisë 2007-2009

Kultura e kredidhënies në 5 vjetarin e fundit në SHBA ka ndryshuar shumë. Shndërrimi i aktiveve në letra me vlerë ndryshoi mënyrën se si bankat rritën biznesin e kredidhënies. Më parë bankat grumbullonin depozita për të financuar një kredi të re po kjo nuk ishte metoda më e shpejtë dhe eficientë për të fituar para. Bankat zbuluan se mund të rrisnin biznesin e tyre shumë shpejt në qoftë se i drejtoheshin tregjeve të kapitalit sesa duke grumbulluar depozita.

Diagrami i mëposhtëm tregon pjesën në % të kredive "Subprime" ndaj total kredive të origjinuara si dhe % e Amerikanëve që jetonin në shtëpitë e tyre kundrejt atyre që jetonin në shtëpi të marra me qira. Kreditë hipotekare "Subprime" përbënin më pak se 10% të të gjithë kredive hipotekare të dhëna deri më 2004 dhe gjatë 2005 - 2006 arritën pikun në 20%. Këto kredi hipotekare, për individë me histori të keqe kredie, me vlerësimin jo të mjaftueshëm të kredisë, ishin të preferuara nga investitorët në tregjet dytësore sepse ofronin norma shumë të larta kthimi.

GRAFIKU NR.1 ECURIA E GJENDJES SË KREDIVE PËR SHTYPI DHE SUBPRIME NË SHBA.



Basel Committee on Banking Supervision, Bank of International Settlements. 2008. *Principles for Sound Liquidity Risk Management and Supervision* (<http://www.bis.org/publ/bcbs144.htm>)

Internal ratings based IRB approach.

Subprime lending (near-prime, non-prime, or second-chance lending) në financë dotë thotë të dhënit kredi me rrezik shumë të lartë për individët.

Kështu gjithnjë e më shumë po rritej përqindja e parave të grumbulluara nga shitja lirë e paketave të kredive “sub-prime”, në tregjet e kapitalit krahasuar me fondet e grumbulluara nga depozitat e klientëve.

Bankat vepronin në mënyrë të tillë sikur të kishin transferuar plotësisht rrezikun e tyre të kredisë. Ato i kushtonin vëmendje sasisë së aktivitetit të kredidhënies sesa cilësisë së tij. Mbështetja në paketat e kredisë “sub-prime” dhe shitja e letrave me vlerë të siguruara nga këto kredi hipotekare në tregjet dytësore ishte bërthama e problemeve të tyre sepse ajo inkurajonte sjellje të shijes grabitqare dhe standarde kredidhënie jo të forta apo të kujdesshme. Rritja dramatike e kredive problematike hipotekare e si rrjedhim humbja e vlerës së Letrave me Vlerë të garantuara me këto lloj kredish çoi në kizë të kredisë, krizë të pasurive të patundshme dhe krizë financiare. Rezultati ishte rënie e madhe e kapitalit të shumë bankave në USA, falimentimi i një numri shumë të madh bankash dhe që pati pasoja negative për tregjet financiare në të gjithë globin. Gjithë tregjet u tkurrën në kredidhënie. Pra që prej fillimit të krizës financiare në vitin 2007 numri i bankave të falimentuara në SHBA ka shkuar në 248, me total aktive prej \$615.2 bilion, total depozita \$ 430.1 bilion dhe kosto e FDIC⁹ \$69 bilion. Gjatë krizës financiare në SHBA falimentuan 3 banka në 2007, 26 banka në 2008, 140 banka në 2009 dhe 80 banka gjatë 2010 (Janar - Qershor 2010).

TABELA NR. 1: NUMRI DHE NIVELI I AKTIVEVE TË BANKAVE TË FALIMENTUARA NË SHBA

Bankat e falimentuara			
Viti	Nr. i bankave të falimentuara	Total i aktiveve të bankave të falimentuara	Humbjet e FDIC's DIF ₁
2007	3	\$2,602,500,000	\$113,000,000
2008	25	\$373,588,780,000	\$15,708,200,000
2009	140	\$170,867,000,000	\$36,432,500,000
2010	80	\$68,171,000	\$16,786,600
Totali	248	\$615,229,280,000	\$69,040,300,00

Burimi: Calculator Plus, Finance & Loan.¹⁰

Pyetja që ngrihej herë pas here ishte: **“Përse bankat ju dhanë kredi individëve, të cilët kurrë nuk do mund të kthenin kredinë mbrapa?”**

Përgjigja do të ishte: **“Bankat nuk donin t’ia dinin për rrezikun e kredisë sepse dukej sikur ishte transferuar nga ato tek investitorët që investonin në letrat me vlerë të tyre”.**

Rregullore Nr. 62 “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për administrimin e rrezikut të kredisë në veprimtarinë e bankave dhe degëve të bankave të huaja, përcaktimi i kriterëve për vlerësimin e rrezikut dhe klasifikimin e kredive dhe aktiveve të tjera, si dhe llogaritjen e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga zhvlerësimi i tyre. Kjo rregullore është miratuar me vendimin nr.62, datë 14.09.2011, dhe ndryshuar me vendim nr. 27, datë 27.03.2013 të Këshillit Mbikëqyrës.

III. Rreziku i normave të interesit

Normat e interesit ndryshojnë vazhdimisht. Ato janë në varësi të kushteve të tregut monetar dhe atij financiar, të cilët në vetvete, janë në varësi të të gjithë veprimtarisë ekonomike të vendit, të ndërhyrjes së autoriteteve monetare e financiare në tregje monetare e të kapitalit, si edhe të ndryshimit të kushteve në tregjet financiare e monetare ndërkombëtare.

Rreziku i normave të interesit është një lloj i veçantë i rrezikut financiar. Ky lloj rreziku ekziston në çdo shoqëri që merr hua ose blen (emeton) instrumente interes pagueuse dhe për çdo investitor apo huadhënës, që investon në instrumente interes pagueuse. Për një bankë ky është një nga rreziqet më të zakonshme me të cilat ajo duhet të përballet, është pasiguria për lëvizjen e ardhshme të normave të interesit. Konkretisht një lëvizje në normat e interesit ndikon në të ardhurat e aktiveve dhe të pasiveve në mënyra të ndryshme. Themi kështu pasi jo çdo lloj aktiv ndikohet njësoj nga kjo lëvizje. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për pasivet. Janë aktivet dhe pasivet afatshkurtra ato që ndikohen në masën më të madhe nga ndryshimi i normave të interesit. Deri këtu nuk është parashtruar problemi që mund të shqetësojë drejtuesit e një banke.

Po të analizojmë themi se ndryshimi i normave të interesit të aktiveve sjell ndryshim të të ardhurave nga këto aktive. Nga ana tjetër ndryshimi i normave të interesit të pasiveve gjithashtu do të sjellë ndryshim të kostos par këto pasive. Në rast se këto ndryshime në të ardhura (aktive) dhe në kosto (pasive) janë afërsisht të barabarta atëherë efekti neto në fitimin e bankës do të jetë i pandjeshëm. Ndërsa kur ky ndryshim mes të ardhurave dhe kostove shitesë që vijnë si pasojë e ndryshimit të normës së interesit është i madh atëherë kjo gjë do të thotë një ndryshim i madh në fitimin e bankës që herë do të rezultojë me fitim të madh dhe herë me fitim të ulët ose humbje.

Vetë kjo është pasiguria në fitime që sjell ndryshimi i normës së interesit. Ndryshimi i normës së interesit gjithashtu e jep efektin e vet edhe tek aktivet dhe pasivet afatgjata. Në këtë rast nuk do të kemi ndryshim të të ardhurave apo të kostove

FDIC: Korporata e sigurimit të depozitave federale. Kur bankat dështojnë, FDIC caktohet si marrësi i tyre.
http://www.calculatorplus.com/savings/advice_failed_banks.html, 2010 Bank Failures.

aktuale (siç ndodhte për aktivet dhe pasivet afatshkurtra) por do të ketë ndryshim të vlerave të tregut të aktiveve dhe pasiveve afatgjata. Dhe përsëri ndryshimi neto në vlerën e pasiveve dhe aktiveve afatgjata do të rezultojë si fitim apo humbje për bankën. Nga sa thamë ndryshimi i normës së interesit sjell pasiguri për fitimet dhe vlerën e një banke që në fund të fundit rezultonte në pasiguri në fitime. Vetë kjo pasiguri është rreziku që vjen nga luhatja e normave të interesit.

Pra rreziku i normave të interesit është mundësia që ndryshimi i normave të interesit të ndikojë në të ardhurat nga interesat dhe në vlerën e aktiveve në treg të çdo investitori. Ndërsa, me ekspozim ndaj rrezikut, kuptohet, vetë prania e rrezikut. Ekspozimet mund të maten dhe të vlerësohen me mënyra të ndryshme.

Si e menaxhon rrezikun e normave të interesit BKT?

Një nga funksionet e bankave si transformues aktivesh është dhe kthimi i tyre nga pasive përgjithësisht afatshkurtra në aktive me afatgjata. Ky transformim kohor i aktiveve ndonëse përben burimin kryesor të ardhurave të bankës ka në të njëjtën kohë edhe koston e saj. Një pjesë e konsiderueshme e kësaj kostoje është dhe rreziku për të humbur nga ndryshimet e disfavourshme në përqindjet e interesit. Normat e interesit në 31 Dhjetor 2009 kanë qenë si me poshtë:

TABELA NR.3: STRUKTURA E BILANCIT TË BANAVE SIPAS VALUTAVE¹¹

	<i>Lek</i>	<i>USD</i>	<i>Euro</i>
Assets			
Cash and balances with Central Bank	3.68%	0.10%	0.70%
Placement and balances with banks	-	1.64%	0.40%
Treasury bills held-to-maturity	9.23%	-	-
Investment securities held-to-maturity	10.46%	6.54%	8.05%
Loans and advances to banks	-	2%	2.39%
Loans and advances to customers	13.34%	8.81%	9.17%
Liabilities			
Customer deposits	5.33%	1.52%	3.38%
Due to banks	5.32%	0.10%	0.10%

Si indikator të vendosjes së normave të interesit për monedhën tonë, BKT përdor REPO-t. Kuptohet depozitave u vendos norma më të ulëta se normat e REPO-ve. Ndërsa normat e kredive në përgjithësi janë në mënyrë të konsiderueshme më të larta se REPO-t. Ndërsa normat e interesave për monedhat e huaja vendosen nga tregu ndërkombëtar, p.sh. për Euro-n përdoret EUROBOR-i ndërsa për USD përdoret LIBOR-i. Tek rregullorja “Mbi rreziqet e tregut” të BOA përcaktohen dy modele për matjen dhe raportimin e rrezikut nga përqindja e interesave: ajo e “Maturimit” dhe e “Kohëzgjatjes”. Por përdorimi i tyre kufizohet vetëm në llogaritjen e rrezikut të tregut për portofolin e letrave me vlerë dhe jo në tërësi për ekspozimin e aktiv/pasiveve. Ndërsa BKT përdor një ndër metodat më bashkëkohore të llogaritjes së rrezikut të normave të interesit siç është modeli “Repricing” Modeli Repricing analizon diferencat midis atyre aktiveve dhe pasiveve interesat e të cilave do të rivlerësohen apo ndryshohen brenda afateve të caktuara kohore. Kështu aktivet dhe pasivet të ndjeshme ndaj normave të interesit ndahen sipas kohëzgjatjes deri në maturim në afate kohore të ndryshme si në tabelën e mëposhtme:

TABELA NR. 4: STRUKTURA E BILANCIT TË BANKAVE SIPAS MATURITETIT TË AKTIVEVE¹²

	<i>UP TO 1 MONTH</i>	<i>1-3 months</i>	<i>3-12 months</i>	<i>1-5 years</i>	<i>Over 5 year</i>	<i>Total</i>
Assets						
Cash and balances with Central Bank	142,263,329	-	-	-	-	142,263,329
Placement and balances with banks	115,637,114	1,617,808	15,387,825	-	-	132,642,747
Treasury bills held-to-maturity	14,635,934	52,461,906	188,542,993	-	-	255,640,833
Investment securities available-for-sale	-	-	2,080,287	28,994,407	18,445,369	49,520,063
Investment securities held-to-maturity	11,934,852	32,510,660	110,392,333	40,127,826	-	194,965,671
Loans and advances to banks	-	-	45,487,888	-	-	45,487,888
Loans and advances to customers	355,240,709	8,212,269	78,264,522	39,573,894	12,979,892	494,271,286
Total	639,711,938	94,802,643	440,155,848	108,696,127	31,425,261	1,314,791,817
Liabilities						
Customer deposits	397,375,804	214,953,386	511,357,665	41,590,446	1,869,557	1,167,146,858
Due to banks	69,175,055	-	-	-	-	69,175,055
Total	466,550,859	214,953,386	511,357,667	41,590,446	1,869,557	1,236,321,913

GAPI 17,3161,079 (-120,150,743) (-71,201,819) 67,105,681 29,555,704

Kur GAPI është negativ tregon nëse normat e interesit do të rriten gjatë vitit të analizës, banka do të paguajë më shumë si për pasivet që riçmohen, ashtu dhe për aktivet që riçmohen. Si pasojë shpenzimet për interesat do të rriten më shumë se sa të ardhurat nga interesat, kështu që marzhi i interesave neto do të ulet.

N.q.se normat e interesit do të ulen do të ndodh e kundërta. P.sh. n.q.s. normat e interesit rriten me 1% për maturitetet 1 deri në 3 muaj, atëherë të ardhurat do të ulen me $1\% \times 120,150,743 = 1,201,507.43$

Kur GAPI është pozitiv (rasti i p.sh. deri 1 muaj) dhe normat afatshkurtra të interesit ngrihen atëherë të ardhurat nga interesat shtohen më shumë se sa shpenzimet për interesat dhe e kundërta kur normat e interesit do të ulen.

N.q.s. GAPI do të ishte zero, ndryshimi i normave të interesit nuk do të kishte asnjë ndikim në të ardhurën neto nga interesat. Në këtë rast dhe rreziku është zero.

Një rrugë tjetër është që banka të spekulojë. Ajo mund të rrisë të ardhurat neto nga interesat në rast se ajo është në gjendje të parashikojë drejtimin e ndryshimit të normave të interesit. Por drejtimi i GAP-it duhet të menaxhohet në mënyrë të kujdesshme.

Le të supozojmë se kemi një GAP negativ dhe menaxherët parashikojnë se normat e interesit do të rriten. Banka në këtë rast do të synojë të rrisë depozitat mbi 1 vit dhe të rrisë investimet afatshkurtra. Por në rast se nuk vërtetohet rritja e normave të interesit, atëherë banka do të rezultojë me marzh neto akoma më të vogël se ai i pritshmi.


BKT për t'u mbrojtur ndaj ndryshimit të maturiteteve të aktiveve me pasivet, adapton normat e ndryshuara të interesave në përfundim të afateve të maturimeve të kontratave të depozitave apo kredive.

Ndërsa efekti i ndryshimit të normave të interesit në investimet si obligacionet shtetërore të Vendeve të huaja, nuk ka ndikim fare në vlerën e tyre kontabël. Pra nuk ndikojnë aspak në bilanc rivlerësimi apo zhvlerësimi i tyre.

IV. Analiza e përfitueshmërisë në sistemin tonë bankar gjatë pesë viteve të fundit


Nëse i hedhim një sy sistemit tonë bankar konstatojmë se niveli i ROA-së dhe ROE-së mbas një ulje drastike më vitin 2011, kanë pësuar një rritje në vitet në vazhdim. Në vitin 2014 ROA ka një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2010, ndërsa ROE ka pësuar një rritje më të ndjeshme krahasuar me të njëjtin vit.

GRAFIKU NR. 2: RAPORTI I ROA DHE ROE NË PERIU DHËN 2010-2014 NË SHQIPËRI¹³




Kjo ka ardhur si rezultat i një sërë faktorëve. Po të shikojmë të ardhurat neto nga interesat ato kanë rënë gati dy herë krahasuar me vitin 2010. Kjo na tregon se kjo rritje e përfitueshmërisë në banka nuk ka ardhur nga aktiviteti kryesor i tyre si kredidhënia apo investimi në bono thesari, po nga aktivitete ndihmëse, si nga komisionet e ndryshme për shërbimet e ofruara nga bankat, të cilat janë rritur si volum po edhe si shumëllojshmëri të tyre. Ato nga 0.22 përqind që zinin ndaj aktiveve mesatare në vitin 2010, në dhjetor të viti 2014 ato zinin 0.74 përqind të aktiveve mesatare, ndërsa të ardhurat neto nga interesat në raport me aktivet mesatare kanë rënë nga 3.94 përqind të totalit të aktiveve në 3.55 përqind për të njëjtën periudhë. Ky fenomen është një fenomen negativ në banka, kur pesha kryesore e të ardhurave duhet të vijë nga aktiviteti kryesor i tyre.

¹³ Annual report 2014, Bank of Albania


GRAFIKU NR.3: TOTALI I TË ARDHURAVE NETO NË RAPORT ME AKTIVET MESATARE¹⁴


Shkaku kryesor i rënies së të ardhurave neto nga interesat në raport me totalin e aktiveve mesatare është rritja e provigjioneve si shkak i përkeqësimit të portofolit të kredive. Norma e kredive me probleme ndaj totalit të portofolit të kredive ka ardhur duke u rritur nga viti në vit duke arritur nivelin më të lartë në vitin 2013 me 24.95 përqind. Në vitin 2014 kemi një rënie të lehtë të këtij treguesi për një sërë shkaqesh.

GRAFIKU NR.4: RAPORTI I KREDIVE ME PROBLEME NDAJ TOTALIT TË KREDIVE TË DHËNA BRUTO¹⁵


Ndër shkaqet kryesore janë: pastrimi i një pjese të kredive me probleme nëpërmjet ekzekutimit të kolateraleve, pra që ka çuar në uljen e volumit të tyre, nga ristrukturimi i kredive që për shkak të ndryshimit të rregullores së Bankës së Shqipërisë më 2013 nuk riklasifikohet në kategori më poshtë, pra nuk ka ndikuar në rritjen e kredive të reja me probleme, apo edhe si rezultat i kërkesës së Bankës së Shqipërisë që një pjesë të mirë të kredive të humbura, bankat duhet t'i nxjerrin jashtë bilancit (write-off). Nga ana tjetër kjo ulje e raportit të kredive me probleme ndaj totalit të kredisë ka ardhur edhe si rezultat i rritjes së volumit të kredive të dhëna, të cilat në krahasim me vitin 2013 kanë pësuar një rritje me 5.88 për qind në vitin 2014. Ndërsa e kundërta ka ndodhur në vitin e mëparshëm, rritja e këtij treguesi ka ardhur kryesisht nga ulja e totalit të portofolit të kredive më 2013 me 24.9 për qind në krahasim me 2012 dhe rritja e kredive me probleme me 3.2 për qind.

Ndërkaq raporti i provigjioneve / rezultatit financiar neto ka variuar nga 205% në vitin 2010 në 106 % në vitin 2014. Ndërkaq ky fond është ulur me 14 për qind në raport me vitin 2010. Kjo tregon se është ulur niveli i provigjioneve të reja të krijuara nga banka. Pra ne kemi gjendje kreditë e trashëguara nga vitet e mëparshme. Pikun ky tregues e ka arritur në vitin 2011 në nivelin 2016% të rezultatit neto, apo një rritje me 50.2% ndaj vitit 2010.


GRAFIKU NR.5: RAPORTI I PROVIGJIONEVE / REZULTATIT FINANCIAR NETO¹⁶

GRAFIKU NR.6: VOLUMI I KREDIVE ME PROBLEME DHE I KREDISË GJATË VITEVE 2010-2014¹⁷.

Ndërkaq sipas strukturës së kredive kreditë më me probleme janë kreditë afat-gjata, të cilat zënë 39.8 për qind të kredive me probleme. Ndërsa vendin e dytë e zënë kreditë afat-shkurtra me 26.3 përqind. Ndërsa në vitin 2014 70.1 përqind e kredive me probleme e zinin kreditë e dhëna në valutë të huaj. Ndërkaq vetëm 59.8 përqind e kredisë është dhënë në valutë. Pra këtu del qartë edhe efekti negativ që ka kredia e dhënë në valutën jo kombëtare.

GRAFIKU NR.7: KREDITË ME PROBLEME SIPAS STRUKTURËS SË TYRE¹⁸.

Shkak tjetër që çon në uljen e të ardhurave neto nga interesat është edhe për shkak të rrezikut të normës së interesit, i cili shfaqet në formën e ndikimit të dy faktorëve, atij sasior, që është rritja e Gap-eve të rishmimit të aktive dhe atij cilësor, që është ndryshimi i nivelit të spread-it të interesave. Niveli i Gap-eve në banka nuk është rritur, përkundrazi bankat kanë qenë më të kujdesshme për të mbajtur nivele optimale të Gap-eve për të kontrolluar dhe rrezikun e normës së interesit. Ndërkohë, si sistem bankar Gap-i deri në një vit ka qenë negativ, që do të thotë se ulja e normave të interesit që aktualisht ka ndodhur gjatë këtyre viteve ka ndikuar pozitivisht në rritjen e të ardhurave nga interesat, gjë që provon hipotezën tonë, që ky rrezik nuk ka qenë predominant në përfitueshmërinë e bankave.

GRAFIKU NR.8: NIVELI I SPREAD-IT DHE POZICIONIT TË HAPUR VALUTOR GJATË VITEVE 2010-2014¹⁹.

Bank of Albania, Annual report 2014
 Bank of Albania, Annual report 2014
 Bank of Albania, Annual report 2014

Ndërkaq në lidhje me humbjet që mund të vinë si rezultat i rrezikut të kursit të këmbimit konstatohet një rritje e pozicioneve të hapura valutore, gjë që potencialisht do të thotë një mundësi më shumë për të pasur rrezik. Por në kushtet që ky pozicion i hapur valutore është long, pra aktivet janë më të mëdha se pasivet, dhe tendenca e kursit të këmbimit në përgjithësi për të gjitha monedhat ka qenë zhvlerësimi i lekut, që do të thotë se bankat kanë përfitur nga ky pozicion i hapur valutore, duke qenë se aktivet janë vlerësuar në lekë më shumë se pasivet, pra se detyrimet e bankës ndaj të tretëve. Pra edhe ky rrezik nuk ka patur ndikim negativ në përfitueshmërinë e bankave.

Konkluzione

- Gjatë periudhës 2010-2014 bankat tregtare në Shqipëri përfitueshmërinë më të madhe e kanë pasur nga ROE dhe jo nga ROA.
- Të ardhurat neto nga interesat gjatë periudhës 2010 – 2014 kanë pësuar ulje të si pasojë e uljes së aktivitetit kryesor të bankave (kredidhënies).
- Pjesa më e madhe e të ardhurave në bankat tregtare Shqiptare ka ardhur nga komisionet dhe shërbimet e ndryshme bankare.
- Norma e kredive me probleme ndaj totalit të portofolit të kredive ka ardhur duke u rritur nga viti në vit duke arritur nivelin më të lartë në vitin 2013 me 24.95 për qind.
- Në vitin 2014 kemi një rënie të lehtë të kredive me probleme si pasojë e ekzekutimit të kolateraleve, ristrukturimit të kredive dhe nxjerrjes jashtë bilancit të kredive të humbura.
- Ulja e raportit të kredive me probleme ndaj totalit të kredisë ka ardhur edhe si rezultat i rritjes së volumit të kredive të dhëna, të cilat në krahasim me vitin 2013 kanë pësuar një rritje me 5.88 për qind në vitin 2014.
- Niveli i Gap-eve në banka nuk është rritur, përkundrazi bankat kanë qenë më të kujdesshme për të mbajtur nivele optimale të Gap-eve për të kontrolluar dhe rrezikun e normës së interesit.
- Në sistemin bankar shqiptar Gap-i ka qenë negativ, që do të thotë ulja e normave të interesit që aktualisht ka ndodhur gjatë këtyre viteve ka ndikuar pozitivisht në rritjen e të ardhurave nga interesat duke rritur kështu nivelin e spread-it ndaj aktiveve mesatare.
- Rreziku i normës së interesit nuk ka qenë predominant në përfitueshmërinë e bankave.
- Pozicionet e hapura valutore janë rritur gjatë këtij pesëvjeçari të fundit, por që duke marrë parasysh se leku është zhvlerësuar kundrejt valutave të tjera kjo ka ndikuar pozitivisht në përfitueshmërinë e bankave.

VI. Rekomandime

Duke qenë se hipoteza jonë u vërtetua, që efekti kryesor në përfitueshmërinë e bankave kanë qenë kreditë me probleme, bankat duhet të jenë shumë të kujdesshme në uljen e tyre. Kjo arrihet nëpërmjet dy rrugëve. Rruga e parë është rritja e totalit të kredive, duke shtuar kredi të reja të shëndosha, të cilat do të përmirësojnë cilësinë e portofolit të kredive, dhe rruga e dytë ulja e kredive me probleme. Kjo do të arrihet në dy forma, së pari aty ku ka mundësi të bëhet ristrukturimi i tyre, dhe aty ku kjo nuk mund të bëhet të çohet në ekzekutimin e kolateralit për të ulur nivelin e tyre. Nxjerrja jashtë bilancit nuk na duket ndonjë rrugë efektive, sepse kjo përmirëson vetëm treguesit, por jo gjendjen reale të tyre.

Shtimi i portofolit të kredive duhet të shoqërohet me procedura të plota dhe të sakta, të cilat të parandalojnë kreditë me probleme në të ardhme. Çdo kredi e re e dhënë duhet të shoqërohet patjetër me vizita në biznes, për të njohur nga afër dhe të shoqërohet me ndjekje periodike nga oficerët e kredisë, për ta pasur situatën nën kontroll. Nuk duhet mjaftuar vetëm me dhënien e tyre, por dhe me një monitorim të kujdesshëm të tyre, i cili nuk duhet të mjaftojë vetëm me njoftimin e klientëve për pagimin e kështit.

Nga ana tjetër bankat duhet të jenë shumë të kujdesshme edhe në mbajtjen parasysh edhe të rreziqeve të tjera, të kontrollojnë GAP-et e hapura, për të minimizuar rrezikun e normës së interesit, si dhe të pozicioneve të hapura valutore.

Po kështu duhet të minimizohen humbjet që vinë nga rreziqet operationale, duke plotësuar të gjitha procedurat e nevojshme, plotësimin me post-pune për çdo pozicion, në mënyrë që të dihen detyrat e sakta nga secili, si dhe çdo veprim të shoqërohet nga kontrolli i katër syve. Të ketë dy firma për çdo veprim të kryer.

Bibliografia

- Banka e Shqipërisë, Raporti vjetor, viti 2010, 2011, 2012, 2013, 2014;
- Boyd, J. and Gianni, D. (2009) “Banking crisis and Crisis Dating: Theory and Evidence”, IMF Working Paper 06/141;
- Bozdo, A. (2011) “Çfarë po ndodh sot me kreditë e këqija” Gazeta Mapo 27 Gusht 2011);
- Bozdo, A. (2012) “Kolaterali, zgjidhja e vetme e problemeve të kredisë?” - Gazeta Mapo 22 korrik Gusht 2012;
- Bozdo, A. (2013) “Edhe një herë për kreditë” - Gazeta Mapo Gusht 2013;
- Bozdo, A. (2012) “Roli i Bankës Qendrore në mbrojtjen e Institucioneve Financiare nga kriza ekonomike globale, nëpërmjet një mbikëqyrje efektive (The role of Central Bank in Financial Institutions protection from global financial crises through effective supervision);

- Cappiello, L.; Kadareja, A., Sorensen, C.K. and Protopapa M. (2010) "Do bank loans and Credit Standart Affect Output? – European Central Bank Working paper No. 1150, January 2010;
- Gadanez, Blaise & Mehrotra, Aaron & Mahanty, M.: (2014) "Foreign exchange intervention and the banking system balance sheet in emerging market economies", Working Paper no. 445, March 2014;
- Gjata, M.&Gjebrea, E. (2010) Risku i kredidhënies në Shqipëri" Economicus, fq. 145-152;
- Hoti, I. (2010) "Impakti i Ekspozimit në Rrezik i Industrisë Bankare në Shqipëri", Economicus Nr. 5, fq. 19-33;
- Kaufman, G. (1984) "Measuring and managing Interest rate Risk" 1984;
- Kadare, A. (2010) "Sa ndikohet PBB-ja nga Krediti Bankar dhe standartet e kredidhënies?", Economicus Nr.5, fq. 35-47;
- Performance of Models-Based Capital Charges for Market Risk (BIS Sep. 1999);
- Principles for Management of Credit Risk Sep. 2000 (BIS);
- PDF Interest Rate Rrezik Management.Associate Professor Department of Finance,The University of Melbourne;
- Principles for Management of Credit Risk Sep. 2000 (BIS);
- Principles for the management and supervision of interest Rate Risk July 2004 (BIS);
- Rregullorja: "Mbi administrimin e rrezikut të kredisë" Nr. 62, datë 14.09.2011;
- Rregullorja: "Mbi administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave" Nr. 31 datë, 30.04.2008;
- Rregullorja: "Për administrimin e rrezikut operacional", Nr. 3, datë 19.01.2011;
- Rregullorja "Mbi rreziqet e tregut" Nr. 72 datë 02.06.1999, ndryshuar me vendim Nr. 98 datë, 19.12.2001;
- Saunders, A. & Cornett, M. M. (2008), "Financial Institutions management" (Southern Illinois Universsity), McGraw 2008;
- Zabai, Anna: (2014) "Managing Default risk" Working Paper no. 467, October 2014;

TRANSMETIMI I NORMËS BAZË SË INTERESIT TEK PRODUKTET BANKARE NË SHQIPËRI

EDI MALA

Student Doktorant, Universiteti Europian i Tiranës

E-mail: edimala@gmail.com

ABSTRAKT

Ky punim studion reagimin e normave të interesit të produkteve bankare ndaj ndryshimit të normës bazë të interesit përfaqësuar nga Repo. Literatura klasike paraqet që efekti i çdo lëvizje të normës bazë të interesit të përçohet e plotë dhe menjëherë tek produktet bankare. Ky punim ka përdorur të dhëna të agreguara rreth normës së interesit të 4 produkte bankare të reja (2 lloj depozitash dhe 2 lloj kredish) në lekë. Periudha e marrë në studim është 96 muaj (01.2007 – 12.2014) për depozitat dhe 54 muaj (07.201 – 12.2014) për kreditë. Për qëllime të studimit u ndërtua një model regresioni ECM për secilën nga këto produkte për të vlerësuar efektet afatgjatë dhe afatshkurtra të ndërveprimit të normës bazë dhe normave të interesit të tyre. Modeli vlerëson përçimin afatgjatë, reagimin pas një ndryshimi të normës bazë si dhe masën e ndryshimit që përçohet nga njëri muaj në tjetrin. Parashikimi që përçimi është i plotë në afatgjatë suportohet nga analiza ku për produktet e depozitave vërehet një sjellje më aktive ndikuar nga konkurrenca mes bankash. Gjithashtu, bankat preferojnë të fokusohen tek produktet afatgjata si tek depozitat ashtu edhe tek kreditë, kjo për faktin që janë produkte me risk më të ulët dhe që ndihmojnë bankat në menaxhimin efektiv të burimeve të tyre. Vihet re që reagimi i bankave ndaj një ndryshimi të normës bazë është i menjëhershëm (brenda një muaji) duke përjashtuar rastin e depozitës 12 mujore që ndikohet nga sezonaliteti i lartë i hapjes së saj. Kredia afatgjatë ka sjellje që tregon që bankat janë më pak të përballura me probleme të rrezikut moral në një situatë rëniesh të njëpasnjëshme të normës bazë.

Fjalë kyç: *Transmetimi monetar, kredi, depozita, normë interesi*

1. Hyrje

Bankat Qendrore (BQ) kudo në botë përdorin një numër kanalesh për të ushtruar politikën e tyre monetare. Nëpërmjet kësaj politike ato përpiqen të përmbushin objektivat e tyre si ruajtja e një norme inflancioni vjetor. Edhe në Shqipëri ky është objektivi kryesor i Politikës Monetare të ushtruar nga Banka e Shqipërisë (“Dokumenti i politikës monetare,” 2015). Njëri nga kanalet më të rëndësishëm është ai i normës së interesit i cili tregon që ndryshimi i normës bazë të interesit influencon ndryshimin e normave të interesit të produkteve bankare që nxit nga ana e saj sjelljen konsumatore. Teoria klasike tregon që çdo ndryshim në normën bazë përçohet e plotë dhe e menjëhershme tek normat e interesit të produkteve bankare. Një politikë monetare ekspansioniste, rrit investimet e bizneseve dhe shpenzimet e individëve (Mishkin, 1996). Megjithatë, studime të tjera empirike tregojnë që ka një ndryshim në përçimin e normës bazë dhe që kjo sjellje varijon në varësi të produkteve bankare apo vendeve (Coricelli, Égert, & MacDonald, 2006).

Në Shqipëri, efekti i normës bazë ka qenë inekzistent deri në 2005. Kjo e ndikuar nga niveli i zhvillimit të tregut bankar por edhe i ekonomisë më gjerë (Kolasi, Shijaku, & Shtylla, 2010). Sidoqoftë, prej 10 vjetësh niveli i ndërmjetësimit financiar është rritur duke bërë të mundur edhe rritjen e efektivitetit të këtij elementi të ushtrimit të Politikës Monetare në vend. Argumentohet që ky kanal vazhdon të ketë ndikim të reduktuar në Politikën Monetare por që po fiton gjithmonë e më tepër rëndësi.

Banka e Shqipërisë (BSH) përdor normën e marrëveshjes së riblerjes 7 ditore (REPO) si normë drejtuese të Politikës së saj Monetare. Ajo ka qenë aktive në përdorimin e normës bazë. Vetëm në 2014 ajo e ka ndryshuar atë 3 herë. Sidoqoftë, shohim që periudha në studim ka qenë e karakterizuar nga norma ulëse të normës së interesit që tregon nevojën e BSH për të ushtruar një politikë ekspansioniste monetare me qëllim rritjen e konsumit nga individët dhe bizneset. Kriza financiare dhe më pas ajo ekonomike dhe e besimit, ka shtyrë BSH për të qenë më aktive në këtë drejtim. Prej disa kohësh BSH kërkon që nëpërmjet veprimeve të saj të ndikojë më drejtpërdrejtë ekonominë reale.

Qëllimi i këtij punimi është të tregojë përçimin e ndryshimit të normës bazë së interesit dhe shpejtësinë e reagimit të institucioneve financiare ndaj këtij ndryshimi. E veçanta e punimit qëndron në 3 drejtime. E para, përdoren normat e interesit të produkteve të veçanta bankare për të analizuar këto ndërveprime. Studime të tjera empirike të kryera nga BSH, fokusohen kryesisht mbi lidhjen e këtij ndryshimi ndaj volumit të kredive. E dyta, shikohen si produktet e kredisë ashtu edhe ato të depozitave. Mendojmë që është e rëndësishme të analizohen edhe aspektet e reagimit të normave të depozitave sepse lidhen ngushtë me elementët ndaj të cilët BSH kërkon të ketë efekt. Dhe e treta, analizohen efektet afatshkurtra dhe ato afatgjata të ndryshimit të normës bazë së interesit. Modeli i ndërtuar vlerëson përçimin afatgjatë, reagimin pas një ndryshimi të normës bazë si dhe masën e ndryshimit që përçohet nga njëri muaj në tjetrin.

Punimi është i organizuar si më poshtë. Në kapitullin 2 trajtohet baza teorike dhe studimet që lidhen me rastin e Shqipërisë. Metodologjia dhe të dhënat e përdorura tregohen në Kapitullin 3. Kapitulli 4 jep rezultatet dhe shpjegon vlerat e tyre. Në përfundim, Kapitulli i fundit bën një përmbledhje dhe jep disa sugjerime që lidhen me ushtrimin e Politikës Monetare nga BSH.

2. Teoria dhe Literatura

Bankat Qendrore kanë një sërë instrumentesh në dispozicion për të ushtruar Politikën Monetare. Kryesisht, BQ e vendeve të zhvilluar apo në zhvillim përdorin instrumente indirekte që janë ato të tregut të hapur, instrumentet mbështetëse dhe të rezervës së detyruar⁶. Këto instrumente ushtrohen me qëllim arritjen e efekteve në ekonominë reale dhe arritjen e objektivave të vënë. Teorikisht ka disa kanale nëpërmjet të cilave efektet e Politikës Monetare përçohen në ekonomi. Sipas (Mishkin, 1996) kemi:

a. Kanali i kredisë

Ky kanal tregon efektin e Politikës Monetare tek kërkesa për kredi e individëve dhe biznesit. Në rastin e politikës ekspansioniste, rritja e sasisë dhe cilësisë së kredive do të sillte një rritje të investimeve dhe të konsumit.

b. Kanali i çmimit të aktiveve

Ky kanal shpjegon impaktin e Politikës Monetare tek çmimet e aktiveve si aksionet, obligacionet, pasuri të patundshme, etj. Pra një rritje e pasurisë së individëve/bizneseve si rrjedhim i një Politike ekspansioniste do të sillte konsum dhe investime më të larta.

c. Kanali i kursit të këmbimit

Kursi i këmbimit tregon vlerën e monedhës kundrejt monedhave të tjera, ndryshimi i normës bazë ndikon gjithashtu edhe kursin e këmbimit. Ky efekt ndikon mbi kërkesën agregate duke patur efekt mbi rritjen e eksporteve neto dhe prodhimin agregat.

d. Kanali i normës së interesit

Një politikë e caktuar do të sillte një ulje (ngritje) të normës bazë e cila sjell ulje (ngritje) të kostos së kapitalit e cila sjell ngritje (ulje) të investimeve që ka efekt direkt mbi ngritjen (uljen) e kërkesës dhe prodhimin agregat.

Kanali që na intereson më shumë është ai i normës së interesit i cili shpreh lidhjen e ndryshimit të normave të interesit mbi kredinë dhe depozitat dhe në një kohë të dytë mbi investimet dhe konsumin e ardhshëm. Instrumenti kryesor është norma bazë e cila është një normë afatshkurtër interesi e cila tregon drejtimin dhe qëndrimin e BQ mbi normat e interesit. Siç mendohet, veprimet e BQ kanë efekt kryesisht mbi normat afatshkurtër të interesit. Normat afatgjata ndikohen më shumë nga pritshmëritë se sa nga norma direkte. Pra, nëse në të ardhmen priten ndryshime të normës bazë atëherë kjo do të

ndikojë sot në normat afatgjata. Mund të kemi që në të njëjtën kohë do të kemi normat afatshkurtra që ndjekin evoluimin e normës bazë por normat afatgjata lëvizin me krah të kundërt për efekt të pritshmërive të ardhshme. Kjo lloj dinamike duhet Mekanizmi i Transmetimit Monetar (MTM). MTM është procesi i cili shpreh lidhjen midis ndryshimit të normës bazë dhe efekteve mbi konsumin dhe investimet e individëve apo bizneseve. Besohet gjerësisht që çdo ndryshim i normës drejtuese të Politikës Monetare pasqyrohet menjëherë dhe e plotë në normat e interesave të kredive dhe depozitave. Teoria na tregon që një Politikë ekspansioniste (siç edhe ka ndodhur gjatë periudhës së marrë në studim), pra një ulje e normës bazë të interesit, sjell një ulje të kostove të kapitalit dhe rrit investimet e bizneseve dhe konsumatore duke rritur prodhimin agregat (Mishkin, 1996). Pjesa e dytë e transmetimit nuk është në fokusin e studimit tonë. Këtu do të studiohet dhe vlerësohet vetëm pjesa e parë e transmetimit, pra, përcimi i lëvizjeve të normës bazë mbi normat e interesit të produkteve bankare.

Sidoqoftë, edhe pse mendohet që normat e interesit të produkteve bankare përçojnë në mënyrë të menjëhershme dhe të plotë efektin e ndryshimit të normës bazë, vërehet një diferencë midis produktesh të ndryshme. Coricelli et al., (2006) vënë re që në vendet e zhvilluara ekziston një diferencë në përcimin e lëvizjeve të normës bazë tek sektori bankar. Megjithatë diferenca mes vendeve të zhvilluara dhe atyre në tranzicion nuk është e madhe. Në përgjithësi shikohet që përcimi është më i plotë tek kreditë e biznesit dhe më pak sesa ato të individëve. Përcimi i depozitave është më i pakët se sa ndaj kredive (Bondt, 2002).

Shqipëria, pas ndërrimit të sistemeve, ka patur një zhvillim të vonuar të tregjeve financiare krahasuar kjo me vendet e tjera.

Banka e Shqipërisë ka si mandat të arrijë dhe të ruajë stabilitetin e çmimeve. Gjithashtu, ajo përpiqet të arrijë edhe objektiva të tjera dytësore si rritja e prodhimit apo edhe punësimi nëpërmjet ushtrimit të një Politike Monetare . Kjo arrihet duke patur një Politikë Monetare e cila përcakton veprimet e ndërmarra për të arritur objektivin parësor.

Vetëm pas 2005, BSH ka filluar të marrë trajtën e një BQ moderne duke përvetësuar instrumentet dhe veprimet e një të tilla. Sipas studimeve të ndryshme, kanali i kursit të këmbimit ka qenë kryesor gjatë këtyre viteve për vetë specificitetin e zhvillimit të tregut financiar në Shqipëri. Sidoqoftë, efektet e këtij kanali kanë ardhur në ulje duke i lënë vendin kanalit të normës së interesit i cili ka marrë rëndësi (Kolasi et al., 2010). Vetëm që prej 2005, BSH ka adoptuar normën e marrëveshjes së riblerjes 7 ditore (REPO) si normë bazë interesi në ekonomi (Fig. 1). Gjithashtu, veprimet e BSH kanë qenë të një BQ moderne me theks tek transparenca, komunikimi dhe cilësia e institucionit (“Politika Monetare në Shqipëri: Nga e shkuara në të tashmen,” 2012).

Politika monetare mund të ndikojë jo vetëm në krahun e kërkesës por edhe atë të ofertës (Weth, 2002). Ky është element i rëndësishëm në reflektimin e Politikës Monetare që duhet marrë parasysh nga BQ. Janë një sërë elementesh që lidhen me karakteristikat e aktorëve financiarë që mund ti kufizojnë ato në përcimin e normës bazë. Gjithashtu ata janë të ekspozuara ndaj problemeve të selektimit të pafavorshëm dhe rrezikut moral. Këto mund të shtojnë problematikën e përcimit dhe vështirësojnë punën e një BQ.

Sistemi bankar është elementi më i rëndësishëm i sektorit financiar shqiptar. Tregjet e tjera financiare nuk ekzistojnë ose janë shumë të vegjël. Bankat janë aktorët e vetëm të ndërmjetësimit financiar midis huamarrësve dhe depozituesve.

Sektori bankar është i mirëkapitalizuar dhe likuid (Fig 2). Ai është një nga sektorët e vetëm në ekonomi, ku governanca është në nivele të mira krahasuar me tregje të tjera në Shqipëri. Ky sektor menaxhohet në mënyrë profesionale dhe ka treguar një stabilitet të vazhdueshëm. Është e rëndësishme që roli i tyre të jetë efektiv si nga ana e arritjes së objektivave të BSH por edhe të përfaqësojnë biznese të shëndosha. Gjithashtu është e rëndësishme që bankat të sigurojnë një funksionim transparent ndaj klientëve që të reflektojë siguri dhe besim.

Sfidat e ardhshme të sektorit bankar lidhen me mundësitë e rritjes së ndërmjetësimit financiar dhe të ketë efekt gjithmonë e më të lartë mbi ekonominë reale. Shqipëria ka potencial për rritje të vazhdueshme të këtij sektori dhe për të patur një efekt pozitiv në rritje në shoqëri. Këtu, roli i BSH është shumë i rëndësishëm jo vetëm si mbikëqyrës por edhe si partner me qëllim që nevojat e tregut të kuptohen dhe adoptohen.

Duhet kuptuar që bankat e nivelit të dytë dhe institucionet e tjera financiare janë kompani private dhe si të tilla kanë si qëllim fitimin. Sidoqoftë, ato kanë përgjegjësi për rolin që duhet të luajnë në shoqëri dhe ndonjëherë për ndihmesën që ato japin në zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar dhe shoqërisë shqiptare. Le të shpresojmë që ky zhvillim të ndodhë gjithmonë e më shumë.

3. Metodologjia dhe të Dhënat

3.1 Të dhënat

Punimi është mbështetur mbi të dhëna të agreguara të produkteve të disbursuara çdo muaj nga bankat në Shqipëri. Këto të dhëna janë marrë nga raporti mujor statistikor i Bankës së Shqipërisë. Janë përzgjedhur 4 produkte bankare me qëllim përfaqësimin e tipit të produktit dhe afatit të tij.

Produktet e përzgjedhura janë:

Depozita e re 12 mujore

Depozita e re 3 mujore

Kredia e re 1-3 vjeçare

Kredia e re +5 vjeçare.

Të dhënat janë mbledhur dhe pasqyruar në baza mujore. Për efekt të disponibilitetit të tyre, normat e depozitave janë marrë për një periudhë 96 mujore (01.2007 – 12.2014) dhe ato të kredive për një periudhë 54 mujore (07.2010 – 12.2014). Fig. 3 jep lidhjen midis këtyre normave dhe normës REPO përgjatë periudhave në studim.

Në rastin e kredive, përzgjedhja është bërë e tillë që të tregojë edhe një efekt të kolateralit që individët apo kompanitë bllokojnë kur marrin kredi të tilla. Kryesisht, kreditë me afat më të shkurtër nuk kanë kolateral, ndërsa ato me afat më të gjatë e kanë një të tillë.

Zgjedhja e normës bazë REPO u bë sepse kjo është instrumenti i përdorur nga BSH për të treguar pozicionim e saj ndaj Politikës Monetare. Normat e tjera të tregut (p.sh. TRIBOR) ndikohet nga nevojat e bankave për fonde, gjë që mund të shtrembërojë analizën tonë. Tregu ndërbankar në Shqipëri nuk mund të jetë kaq aktiv për vetë faktin që bankat janë likuide. BSH nëpërmjet veprimeve të saj është më e pranueshme si aktor në këto lloj transaksionesh.

3.2 Metodologjia

Sipas studimeve të shumta, supozohet që ekziston një lidhje midis normës bazë dhe normave të interesit të produkteve të cilat lëvizin së bashku. Megjithatë, bankat e përçojnë këtë lëvizje duke u nisur nga arsye të ndryshme si kosto të ndryshme (risku apo operacionale), elasticitetin e produktit apo edhe informacionin që ekziston në treg.

Në punimin tonë është marrë e mirëqenë që krahu apo masa e lëvizjes i normës bazë ka të njëjtin efekt mbi normat e interesit. Këto lloj ndikimesh mund të maten në një studim tjetër.

Sidoqoftë, qëllimi i këtij studimi është të tregohet lidhja midis ndryshimit të normës bazë dhe ndryshimit të normës së interesit të produkteve bankare. Në ndërtimin e modelit është futur vetëm varësia e normës bazë dhe normave bankare. Këto dinamika analizohen nëpërmjet modeleve error correction (ECM) në mënyrë që të kapen si efektet afatshkurtra por edhe ato afatgjata të normave të interesit. Këto modele ECM përdoren gjerësisht për të shprehur lidhjet sidomos të variabileve ekonomike. Modeli mund të shprehet nga ECM e mëposhtme:

$$dNI_{p,t} = \alpha_p + \beta_p dREPO_{p,t} + \gamma_p NI_{p,t-j} + \delta_p REPO_{p,t-j} + \varepsilon_{p,t} \quad (1)$$

ku,

NI – norma e interesit e një produkti bankar të caktuar

REPO – norma bazë e interesit

t – muajt

p – produkti bankar

Nëpërmjet Kriterit të Informacionit të Akaike (AIC) llogaritet numri i vonesave në kohë në muaj (j) për secilin nga produktet dhe që tregon se sa ka qinë diferenca në muaj midis ndryshimit të normës REPO dhe ndryshimit të normës së interesit.

Indikatorët e ekuacionit 2 llogariten nëpërmjet Metodës së Katrorëve të Vegjël (OLS). Llogaritjet janë kryer me Eviews Indikatorët e ekuacionit 2 shërbejnë për të llogaritur vlerat A dhe C të ekuacionit 2.

Mendohet që ekziston një ekuacion afatgjatë ekuilibri që mund të shkruhet si me poshtë:

$$NI_{p,t} = A_p + C_p REPO_t \quad (2)$$

ku,

A – është masa që normat e interesit të produkteve rrinë mbi/nën normën REPO. Produktet e kredisë janë vendosur mbi normën REPO ($A > 0$) dhe ato të depozitave nën normën REPO ($A < 0$).

C – është përcëpi afatgjatë dhe tregon se sa përçohet ndryshimi i REPO tek norma e interesit të produktit bankat. $C=1$ tregon një treg konkurrues ku bankat nuk ndikohen nga elementë të tjerë si psh koston.

Ky model ndërtohet dhe llogaritet për secilin produkt dhe shërben për të llogaritur të gjithë indikatorët përkatës, $A_p = -\alpha_p / \gamma_p$ dhe $C_p = -\delta_p / \gamma_p$.

Është e pranuar gjerësisht që ekziston një lidhje midis normës bazë dhe normave të interesit të produkteve bankare. Kjo mund të shikohet edhe nga grafikët. Sidoqoftë testet statistikore janë të nevojshëm. Në rastin e studimit tonë kemi zgjedhur testin e kufijve të Wald (Pesaran, Shin, & Smith, 2001). Sipas këtyre autorëve nëse vlera e F-statistics është mbi kufirin e sipërm, atëherë ekziston një lidhje afatgjatë. Nëse vlera është nën kufirin e poshtëm nuk ekziston lidhja. Nëse vlera është mes kufijve atëherë nuk mund të themi gjë.

Si më poshtë hipoteza nul:

$H_0: \gamma_p = \delta_p = 0$ tek ekuacioni (1)

Testi i vlerësuar nëpërmjet procedurës përkatëse në Eviews jep që për të katër ekuacionet e produkteve tona, Nul hidhet poshtë duke pranuar faktin që ekziston një lidhje afatgjatë midis normës bazë dhe lëvizjeve të normave të interesit. Ky ishte edhe prezumimi fillestar, intuitiv dhe ekonomik.

Në rastin tonë kjo lidhje tregon edhe njëherë forcën e kanalit të normës së interesit dhe rëndësisë që ka marrë prej disa kohësh. Efekti i një lëvizje në normën e interesit është i provuar. Masa e këtij efekti do të tregohet në rezultatet e vlerësuar në kapitullin tjetër.

4. Rezultatet

Ekuacionet e vlerësuar më sipër japin rezultate që janë në linjë me pritjet tona. Të gjitha vlerësimet janë kryer nëpërmjet programit statistikor Eviews 8. Shikoni anekset për më shumë detaje.

Tab. 1 jep një përmbledhje të indikatorëve që dalin nga vlerësimi i ekuacioneve të secilit produkt bankar. Këto indikatorë shërbejnë për të diskutuar gjetjet tona.

Indikatorit tregon se sa përqind e ndryshimit të normës së interesit të produkteve të ndryshme mund të shpjegohet nga ndryshimi i normës bazë së interesit.

Modeli i ndërtuar ka një fuqi shpjeguese (adj) të ulët, gjë që pritej. Modeli është ndërtuar për të shfaqur lidhjen e ndryshimit të normës bazë dhe ndryshimit të normave të interesit të produkteve bankare. REPO përdoret prej pak kohësh dhe mendohet që nuk ka efektin e duhur mbi reflektimin e Politikës Monetare (Kolasi et al., 2010). Gjithashtu, kjo nënkupton që ka një sërë elementësh të tjerë që ndikojnë këtë sjellje.

Kredia +5 vjeçare ka një fuqi shpjeguese më të lartë se sa produktet e tjera. Kjo mund të shpjegohet me riskun më të ulët që ky produkt ka duke qenë se kryesisht ky produkt është i siguruar me kolateral. Produktet e depozitave dhe kredia 3 vjeçare kanë një fuqi shpjeguese të ulët e cila mund të lidhet me kostot operationale që ato përfaqësojnë. Kryesisht këto produkte janë të standardizuara dhe janë më të shumta në numër. Bankat kanë procese që duhet të ndjekin si dhe kosto që përballen me ndryshimin e normave të interesit dhe promovimit të tyre, fjala bie nëpërmjet reklamave. Gjatë periudhës së marrë në shqyrtim tregu bankar ka patur një rritje të vazhdueshme si të numrit të degëve ashtu edhe të numrit të punonjësve. Për këto lloj produktesh është e nevojshme të kihet rrjet i gjerë dhe punonjës të trajnuar. Gjithashtu, mendojmë që indikatorë të performancës financiare të bankës janë të rëndësishëm dhe me peshë në analizën e tyre të ndryshimit të normave të interesit

Sjellja afatshkurtër e modelit jepet nëpërmjet 2 indikatorëve:

a. Shpejtësia e përshtatjes (e cila jepet me $100*|\gamma|$)

Kjo shpejtësi jep masën e përshtatjes të ndodhur në muajin t+1 ndaj ndryshimit të normës bazë ndodhur në muajin t. b. Vonesa e përshtatjes (e cila jepet në j muaj)

Ky koeficient jep vlerën në muaj pas sa muajsh bankat reagojnë ndaj një ndryshimi të normës bazë. Kjo vlerë duhet të jetë minimalisht 1 sepse BSH i deklaron vendimet për ndryshim të normës bazë në fund të muajit.

Kështu, bankave iu ngelen vetëm disa ditë që është një kohë e pamjaftueshme.

Sjellja afatgjatë e modelit jepet nëpërmjet indikatorëve:

a. Intercepti (A)

Ky indikator tregon vlerën që një normë interesi produkti është vendosur mbi(nën) normën bazë të interesit në periudhën afatgjatë. Pritja është që depozitat kanë norma nën vlerën mesatare afatgjatë të normës bazë, ndërsa kreditë mbi të.

b. Përçimi (C)

Indikatorit i përçimit afatgjatë tregon se sa pjesë të ndryshimit të normës bazë është reflektuar në normën e interesit në periudhën afatgjatë. Vlera 1 e këtij indikatorit jep një sjellje ideale të bankave, ku vendimi i ndryshimit nuk ndikohet nga elementë të tjerë si kostot apo të tjera.

c. Vlera mesatare afatgjatë (LRER)

Kjo është vlera afatgjatë e normave të interesit e përcaktuar nga ekuacionet e ndërtuara.

4.1 Sjellja afatshkurtër

Është interesant fakti që bankat reagojnë shpejt ndaj një ndryshimi të normës bazë. Kryesisht ato veprojnë brenda 1 muaji me përjashtim të depozitës 12 mujore kur ky reagim vjen pas 5 muajsh. Kjo sjellje mund të shpjegohet me sezonalitetin e lartë të këtij produkti. Një pjesë e mirë e klientëve janë emigrantë të cilët kthehen pranë familjeve të tyre gjatë festave të fundvitit apo gjatë pushimeve të verës. Bankat për të patur një efekt më të madh, i korrigjojnë normat e depozitave përpara këtyre momenteve duke reflektuar ndryshimet e mundshme të normës bazë. Përsa i përket kredive, reagimi i bankave është i menjëhershëm duke qenë në linjë me pritjet e BSH dhe klientëve.

Normat e kredive duhet të jenë të bazuara në normat e tregut. Kjo normë mund të jetë norma ndërbankare TRIBOR, norma e bonove të thesarit apo normë bazë e përcaktuar nga bankat vetë. Kësaj norme bankat i shtojnë një diferencë (spread) që është në përfundim norma totale që i prezantohet klientit. Përveç tyre bankat përdorin edhe norma fikse për periudha të caktuara kohe me qëllim tërheqjen e klientëve. Sidoqoftë, analiza tregon që bankat ose nëpërmjet normave ndërbankare ose ofertave të ndryshme veprojnë shpejt me qëllim kapjen e pjesëve të tregut. Pavarësisht masës së ndryshimit, bankat veprojnë shpejt edhe për arsye të imazhit. Në një kohë kur norma bazë ka qenë në trend rënës, bankat kanë qenë të presuara nga publiku për të përçuar këtë rënie në normat e tyre të kredive. Në përgjithësi, publiku (individët dhe bizneset) i kanë quajtur normat e interesit të kredive të larta dhe institucionet mbikëqyrëse kanë ushtruar presion për ti ulur këto norma.

Shpejtësia e korrektimit jep masën mesatare të korrektimit çdo muaj. Kredia +5 vjeçare ka shpejtësinë më të madhe duke treguar gatishmërinë e bankave për të reflektuar ndryshimin e normës bazë. Kjo vlerë është 63.44% që do të thotë që gati

2/3 e ndryshimit plotësohen që muajin e parë. Kjo sjellje e bankave nënkupton që ato mendojnë që klientët kanë njohuri më të larta mbi këtë produkt dhe prandaj bankat shpejtojnë të reflektojnë ndryshimet e mundshme. Është e kuptueshme që për klientët kostot që lidhen me këto produkte janë të larta dhe procesi i marrjes së tyre më i gjatë. Për këtë arsye, ata marrin një informacion të plotë mbi normat e interesit dhe kushtet e tjera. Prandaj, bankat nuk kanë interes të mos reflektojnë menjëherë ndryshimet e normave bazë duke i bërë ato konkurruese në treg. P.sh, tek individët kredia hipotekare zë 71% të stokut të kredive për këtë segment klientësh, gjë që tregon interesin dhe kujdesin që kanë bankat ndaj këtij produkti.

Depozita 12 mujore ka shpejtësinë më të ulët me sa duket nga sezonaliteti i lartë i kërkesës si dhe fakti që individët vlerësojnë edhe faktorë të tjerë si p.sh, siguria. Kjo lloj sjellje mund të shpjegohet edhe nga fakti që një pjesë e madhe e depozitave janë në monedhë të huaj që ndikohet nga lëvizja e normave bazë jashtë Shqipërisë.

Te dy këto koeficientë janë statistikisht të rëndësishëm dhe përforcojnë vlerësimet tona.

4.2 Sjellja afatgjatë

Me sa shihet nga tabela vlera e depozitës 3 mujore është 3.61% ndërkohë që vlera mesatare e REPO ka qenë 4.77%. Depozita 12 mujore ka qenë 4.90%. Kreditë kanë qenë në vlerat 13.26% për atë 1 - 3 vjeçare dhe 9.92 për atë +5 vjeçare. Gjatë periudhës së marrë në studim, REPO ka patur një vlerë në zbritje nga maksimumi 6.25% përgjatë fundit të 2007 dhe gjithë 2008 në 2.25% që mbylli 2014.

Paraqitje grafike e marrëdhënies afatgjatë është tek Fig. 4.

Siç edhe pritej, përcimi është i plotë tek të gjithë produktet bankare. Vlerat e tregojnë qartë që të gjitha produktet janë mbi vlerën 1 që tregon që efekti i normës bazë në Politikën Monetare është i plotë. Megjithatë shohim disa ndryshime si midis produkteve ashtu edhe midis afateve. Ky ndryshim është edhe qëllimi i studimit tonë. Produktet e depozitave kanë një përcim më të lartë se ato të kredive. Kjo bie ndesh me gjetje të tjera të vendeve të zhvilluar dhe ato në tranzicion. Sipas Sander dhe Kleimeir (2004a), tek depozitat konkurrenca ndikon më shumë se tek kreditë dhe siç duket ka të njëjtin efekt edhe në Shqipëri.

Sistemi financiar shqiptar është likuid dhe i mirëfinancuar. Për bankat kryesore shqiptare depozitat kanë qenë të bollshme. Atëherë bankat, në një situatë rënëse normash bazë, depozitat janë përdorur për të kontrolluar përfitueshmërinë e tyre. Mungesën e të ardhurave nga kreditë, bankat janë munduar ta kompensojnë duke ulur normat e depozitave më shumë se sa ulja e normës bazë dhe përfituar nga kursimi i shpenzimeve. Prej njëfarë kohe dukej sikur normat e depozitave në lekë nuk ishin të lidhura me situatën e tregut dhe që likuiditeti i lartë dhe mirëkapitalizimi nuk po i shtynte bankat të ulnin normat e interesit të depozitave. Fakti që përcimi është përtej 1 tregon që ndryshimet që për njëfarë kohe tregu nuk ka reaguar siç duhej dhe vetëm më vonë është munduar të kompensojë kohën e humbur.

Në përgjithësi sa më i gjatë afati, aq më i lartë përcimi që mund të shpjegohet me konkurrencën e lartë për këto produkte.

Shumica e depozita dhe kredive janë në afatet më të gjata. Këto produkte sigurojnë të ardhura të parashikueshme dhe stabil.

Është interesant fakti që Intercepti është më e lartë tek kredia 1 - 3 vjeçare se sa ajo tek +5 vjeçare gjë që vërteton edhe përzgjedhjen tonë të produkteve në fillim. Produktet më afatshkurtra janë kryesisht jo të siguruara me kolateral dhe kjo vlerë më e lartë tregon në një farë mase vlerësimin e riskut nga ana e bankave. Mesatarisht, bankat e vlerësojnë këtë risk me 3,82%.

5. Konkluzione dhe Sugjerime

Punimi ka për qëllim të studiojë sjelljen e normave të interesit të produkteve bankare ndaj ndryshimit të normës bazë të interesit REPO. Prej disa vitesh tashmë kjo normë ka qenë elementi kryesor dhe më publik i ushtrimit të Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë. Gjatë periudhës së marrë, kjo normë ka qenë në një trend kryesisht rënës që ka reflektuar edhe dëshirën dhe nevojën e BSH për të ndikuar rritjen ekonomike të vendit. Shqipëria ka njohur një rritje ekonomike të ulët e ndikuar fort nga kriza ekonomike dhe financiare e vendeve fqinjë. Italia dhe Greqia si vendet partnere më të rëndësishme kanë ndikuar për frenimin e rritjes ekonomike.

Në studimin tonë, u vlerësuan disa indikatorë afatgjatë dhe afatshkurtër të lidhjes midis ndryshimit të normës bazë dhe ndryshimit të normave të interesit të produkteve bankare të marra në studim. Përzgjedhja e këtyre norma u bë me qëllim të studionim produktet e kredisë dhe depozitave si dhe afatin e tyre të shkurtër apo të gjatë. Me sa kemi dijeni, ky punim është i pari që studion në këtë nivel mekanizmin e transmissioinit monetar dhe që shikon si produktet e kredisë ashtu edhe ato të depozitave. Studimet e BSH kanë qenë të vendosura mbi volumet e kredisë në linjë me fokusin e saj si institucion.

Nëpërmjet ECM u vlerësuan koeficientet përkatës. Këta indikatorë përfaqësojnë si sjelljen afatshkurtër ashtu edhe atë afatgjatë. Kjo është interesante dhe e nevojshme për të patur një pamje të plotë të sjelljes së bankave.

Gjithashtu, testet tregojnë që ekziston një lidhje afatgjatë midis normës bazë dhe gjithë produkteve bankare në linjë me teorinë dhe studime të tjera të ngjashme.

Rezultatet treguan që, në afatgjatë, përcimi është i plotë tek të gjitha produktet bankare. Ky përfundim është në linjë me teorinë si dhe përpjekjet e BSH këto kohë. Sidoqoftë, ishte interesant fakti depozitat kishin një përcim më të lartë se kreditë me siguri e ndikuar nga fakti që ato janë kthyer një element që ndikon fort përfitueshmërinë e bankave. Hannah dhe Berger (1992) argumentojnë që në një situatë rënëse normash bazë, normat e depozitave bien më shpejt se ato të kredive.

Informacion i marrë nga website www.aab.al, vlerat për Dhjetor 2014. Kalkulimet janë të vetë autorit.

Për sa i përket sjelljes afatshkurtër, kreditë ishin më të shpejta në reagimin e tyre ndaj ndryshimit të normës bazë. Kjo shpjegohet me faktin që aktorët politikë kanë presuar gjithmonë bankat për të përçarur sa më shpejt ndryshimet. Gjithashtu për vetë natyrën e këtyre produkteve, klientët (individët dhe bizneset) janë më të kujdesshëm që të kërkojnë dhe zgjedhin produktin me koston më të ulët. Kjo gjë shtyn bankat që të jenë të kujdesshme në këtë drejtim për të qenë sa më konkurruese në treg. Gjithmonë e më tepër, produktet bankare po kthehen në produkte me të njëjta tipare dhe çmimi i tyre (pra, norma e interesit) kthehet në elementin më të rëndësishëm.

Është interesante të veçohet sjellja e depozitës 12 mujore. Ky afat depozite ka një shpejtësi të ulët përshtatjeje dhe lëvizje në muajin e 5. Edhe pse e ngadaltë në reagim, ajo ka përcimin më të lartë mes produkteve tona. Mendojmë që kjo lloj sjellje vjen nga sezonaliteti i lartë i hapjes së tyre. Kjo depozitë ka pikën e saj gjatë muajve të verës dhe fundvitit kur emigrantët e shumtë kthehen për pushime. Ka një konkurrencë të lartë për këtë afat depozite që përfaqëson rreth 70% të volumit të depozitave. Kjo shpjegon edhe përcimin më të lartë.

Siç edhe pritej modeli i ndërtuar për të shprehur lidhjen e ndryshimit të normës bazë dhe ndryshimit të normave të interesit, kishte një fuqi shpjeguese të ulët. Kjo nuk është në linjë me studime të tjera por është e shpjegueshme në rastin e Shqipërisë. Bankat ndikohen nga elementë të tjerë si kostot që ndikojnë marrjen e vendimit të ndryshimit të normës së interesit. Kredia 5+ vjeçare kishte vlerën më të lartë (edhe pse larg vlerës normale) duke treguar që ky produkt ka fokus nga ana bankave si produkt që rrit të ardhurat dhe ka kosto risku të ulët. Pra, karakteristikat e secilës bankë ka akoma një ndikim të madh në përcaktimin e sjelljes së tyre.

Ky punim ka presupozimin që sjellja e bankave është e njëjtë si në një mjedis rënës apo rritës normash bazë. Sigurisht, kjo duhet analizuar dhe vërtetuar në të ardhmen.

Nga analiza del që, në përgjithësi, bankat në Shqipëri kanë qenë aktive në rolin e tyre dhe sjellja ka qenë në linjë me drejtimin e Politikës Monetare të vendosur nga BSH. Ato kanë përçarur efektet e Politikës Monetare edhe pse ka një diferencë në reagimin e tyre në afatshkurtër. Problemet e rrezikut moral nuk shfaqen këtu. Produkte të ndryshme kanë sjellje të ndryshme, kjo në varësi të elementëve si përfitueshmëria, struktura e bilancit, objektivat afatshkurtra, etj.

Për BSH, është interesante të vlerësohet efekti i Politikës së saj Monetare. Por, është me vlerë që të kemi një detajim dhe kuptim se si reagojnë produktet e ndryshme në këtë proces. Teoria thotë që ndryshimi i normës bazë sjell një përcim të plotë dhe të shpejtë të këtij ndryshimi tek të gjitha normat bankare të interesit. Realiteti është i ndryshëm me sjellje jo uniforme. Edhe pse përcimi u vlerësua i plotë, sjellja afatshkurtër ishte e ndryshme si në afate ashtu edhe në masën e përshtatjes. Sot, për shkak të një ulje të vazhdueshme të normës bazë, sjellja e klientëve ka ndryshuar dhe potencialisht kjo do të sjellë ndryshimin e sjelljes së bankave dhe në fund të efektit të kanalit të normës së interesit. Marrja parasysh e këtyre faktorëve është me vlerë për përpilimin e veprimeve efektive të Politikës Monetare.

Sidoqoftë disa pyetje ngelen dhe mund të jenë pjesë të studimeve të ardhshme. Për të patur një pamje akoma më të qartë duhet që ky lloj informacioni dhe analize të kryhet në nivel banke për të arritur në përfundimet se si reagojnë çdo bankë specifike ndaj ndryshimeve të normës bazë. Kjo do të tregojë edhe se si karakteristikat e secilës bankë ndikon sjelljen e saj në përcaktimin e normave të interesit. Gjithashtu është e nevojshme që kjo analizë të detajohet për segmente klientësh të ndryshëm duke menduar që sjellja ndryshon mes klientëve individë dhe atyre biznes. Shtimi i produkteve të tjera, p.sh kartat e krediti, kredia kufi, llogaritë e kursimit apo ato rrjedhëse, do të sillte një pamje mjaftueshëm të detajuar për të nxjerrë përfundime se si bankat sillen në vendosjen e normave të interesit dhe cili është efekti i ndryshimit të normës bazë.

Aneksi 1: Figura dhe tabela

FIGURA 1: EVOLUIMI I REPO NË KOHË




FIGURA 2: SEKTORI BANKAR SHQIPTAR




FIGURA 3: LIDHJA E REPO ME DEPOZITAT E KREDITË





TABELA 1: VLERËSIMI I KOEFICIENTEVE

PRODUKTI	AFATSHKURTËR		AFATGJATË			Adj R2
	% Shpejtësia e përshtatjes	Hapa vonesë (muaj)	Intercepti (A)	Përcëimi ('C)	Vlera AGJ	
DEP3M	19.49	1	-2.50	1.28	3.61	0.15
DEP12M	8.82	5	-3.61	1.78	4.90	0.14
KREDI1-3V	27.07	1	9.16	1.03	13.26	0.11
KREDI+5V	63.44	1	5.34	1.15	9.92	0.29

FIGURA 4: PARAQITJA GRAFIKE E LIDHJES AFATGJATË



Bibliografia

- Bondt, G. de. (2002). RETAIL BANK INTEREST RATE PASS-THROUGH: NEW EVIDENCE AT THE EURO AREA LEVEL.
- Coricelli, F., Égert, B., & MacDonald, R. (2006). *Monetary transmission mechanism in Central and Eastern Europe: Gliding on a wind of change*. Retrieved from <http://141.213.232.243/bitstream/2027.42/57230/1/wp850.pdf>
http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=909511&
- Dokumenti i politikës monetare. (2015).
- Hannan, T. and A. Berger. (1991). The rigidity of prices: evidence from the banking industry.
- Kolasi, G., Shijaku, H., & Shtylla, D. (2010). Mekanizmi i transmetimit monetar në shqipëri.
- Mishkin, F. (1996). The Channels of monetary transmission.
- Pesaran, M. H., Shin, Y., & Smith, R. J. (2001). Bounds testing approaches to the analysis of level relationships. *Journal of Applied Econometrics*. doi:10.1002/jae.616
- Politika Monetare në Shqipëri: Nga e shkuara në të tashmen. (2012).
- Sander, H. and S. Kleimeier. (2004a). Convergence in Euro-Zone Retail Banking? What Interest Rate Pass-Through Tells Us about Monetary Policy Transmission. *Competition and Integration*.
- Weth, M. A. (2002). The Pass-Through from Market Interest Rates to Bank Lending Rates in Germany. *SSRN eLibrary*, (March). doi:10.2139/ssrn.320112
- Burime nga interneti:**
Kredia për ekonominë sipas qëllimit, Dhjetor 2014. <http://www.aab.al/al/statistics.php>

MOTIVIMI DREJT VENDIMARRJES ETIKE: RASTI I KONTABILISTËVE SHQIPTAR

LORETA BEBI

Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Fakulteti Ekonomik, Profili Financë.

E-mail:loreta.bebi@yahoo.com

BRUNILDA LLAFTIU

Fondacioni "Fryma e Dashurisë", Rruga e Kavajës 151, Tiranë

E-mail:brunallaftiu@yahoo.it

ABSTRAKT

Në botën e sotme të biznesit vihet re që roli i kontabilistit është tejet i rëndësishëm dhe jetësor. Menaxherët dhe vendimmarrësit e tjerë të një kompanie i bazojnë vendimet e tyre kryesisht në informacionin e ofruar prej kontabilistëve. Duke qenë se saktësia e vendimeve të marra varet në seriozitetin e informacionit financiar, kohët e fundit i është kushtuar një rëndësi e veçantë etikës në profesionin e kontabilistit. Ashtu sikurse në shumë vende të botës edhe në vendin tonë IEKA, nëpërmjet hartimit të Kodit të Etikës, mbështet kontabilistët në njohjen dhe zgjidhjen e situatave apo dilemave specifike me të cilat ato mund të përballen çdo ditë gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Gjithsesi vihet re se edukimi etik i vetëm nuk siguron sukses për të vepruar gjithmonë në mënyrë etike. Vullneti i një individi dhe motivimi i tij përbëjnë faktorët thelbësor që çojnë në vendimmarrje etike. Procesi i vendimmarrjes etike sipas Rest (1986) përshkruhet si një proces i cili kalon në katër etapa dhe konkretisht njohja, qëllimi, gjykimi dhe sjellja etike. Qëllimi i këtij punimi është njohja e disa faktorëve të rëndësishëm dhe influencues në motivimin etik të kontabilistëve të drejtimit dhe shpjegimi i marrëdhënieve midis këtyre faktorëve me motivimin e sjelljes etike. Nuk ka diskutim në lidhje me faktin se kompanitë kanë një rol parësor dhe vital në motivimin etik të punonjësve të tyre. Ky punim do të konkludojë me disa rekomandime, implementimi i të cilave nga ana e kompanive mund të rezultojë në motivim të punonjësve gjë që automatikisht përkthehet në qëllime të kontabilistëve për të vepruar në mënyrë etike.

Fjalë kyç: *procesi i vendimmarrjes etike, motivimi, sjellja etike, modeli i Rest(1986), kontabilistët e drejtimit.*

Hyrje

Në realitetin ekonomik të shekullit në të cilin po jetojmë sjellja individuale e çdo punonjësi duke nisur nga menaxherët e deri tek punonjësit e thjeshtë është themeli mbi të cilin mbështetet reputacioni i një njësie biznesi. Sjellja e çdo punonjësi ka një ndikim thelbësor dhe të drejtpërdrejtë në vlerën e tregut, aftësinë për të tërhequr dhe mbajtur klientët, investitorët, punonjësit ose konsumatorët.

Sipas (Zengin et al., 2009) në botën e sotme të biznesit kontabilistët luajnë një rol të rëndësishëm. Informacioni të cilin ato përgatisin është vendimtar dhe shumë i rëndësishëm duke qenë se ndihmon menaxherët, investitorët dhe palët e tjera të interesit në marrjen e vendimeve ekonomike kritike. Në të njëjtën kohë duhet theksuar se çdo parregullsi në sjellje nga pikëpamja etike e kontabilistëve mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme për shoqërinë (Ëilliams & Elson, 2010). Një shembull për të gjitha këto janë rastet e skandaleve financiare të disa kompanive të fuqishme si Enron, WorldCom, Parmalat etj. Këto skandale vënë në dyshim moralitetin e biznesmenëve në përgjithësi dhe të kontabilistëve në veçanti. Është rënë dakord se kontabilistët kanë qenë kontribuuesit kryesor në rënien e standardeve etike të një biznesi.

Disa studime të bëra në fushën e kontabilitetit mbështesin faktin se një kontabilist i suksesshëm përveç aftësive të përgjithshme të biznesit, aftësive njerëzore dhe atyre teknike duhet domosdoshmërisht ti përmbahet rigorozisht standardeve etike të ushtrimit të profesionit (Taicu et al., 2007; Amat et al., 1991). Kontabilistët shpeshherë janë të detyruar të bëjnë zgjedhje etike në lidhje me situata të ndryshme, disa prej të cilave janë transparente dhe të qarta për to dhe një pjesë tjetër janë më pak të qarta (Shaub et al., 2005).

Organizata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) në raportin hulumtues të saj të titulluar “Rindërtimi i besimit të publikut në raportimin financiar-Një këndvështrim ndërkombëtar”, i botuar në vitin 2003, duke marrë shkas nga pasojat e kolapseve të Enronit dhe WorldCom në vitin 2002, konkludon se skandalet financiare të asaj kohe ishin simptoma të problemeve më të thella dhe theksojnë se përmirësimi i standardeve etike, përshtatshmëria e mekanizmave të raportimit financiar, cilësia e auditimit dhe forcimi i kontrollit qeveritar janë faktorë kyç që luajnë rol në përmirësimin e besimit të publikut. Organizatat e profesionistëve të kontabilistëve në mbarë botën kanë hartuar standardet e etikës profesionale.

Pa dyshim që etika është një element shumë i rëndësishëm dhe vital veçanërisht në profesionin e kontabilistit, por a është ajo e mjaftueshme për të siguruar sjellje etike? Shumica e studimeve në lidhje me këtë çështje arrijnë në një përfundim konsistent se etika është një domosdoshmëri e rëndësishme në profesionin e kontabilistit të drejtimit. Por, vetëm të mësuarit e etikës nuk garanton sukses në shfaqjen e sjelljes etike. Nga ana tjetër, është provuar se të mësuarit e etikës është i domosdoshëm për të ndërmarrë vendimmarrje etike, por nuk mjafton (Hajjaëi, 2008; Armstrong, 2003; Zengin et al., 2009).

Duhet theksuar se pjesa më e madhe e studimeve të bëra deri më tani në lidhje me etikën kanë pasur për qëllim përcaktimin e objektivave dhe metodave më të përshtatshme për tu përdorur në të mësuarin e etikës së biznesit apo identifikimin e personave më të përshtatshëm për ti mësuar etikën studentëve në kurset e kontabilitetit etj. Vihet re se çështjes së motivimit dhe gatishmërisë së individëve për tu angazhuar në vendimmarrje etike, edhe pse një faktor shumë i rëndësishëm, i është kushtuar një vëmendje shumë e vogël (Armstrong, 2003; Brands, 2010).

Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi kryesor i këtij punimi është identifikimi i faktorëve më të rëndësishëm dhe kryesor në lidhje me motivimin etik dhe shpjegimin i marrëdhënies midis këtyre faktorëve dhe njëkohësisht i marrëdhënies së këtyre faktorëve dhe fazës së motivimit etik (qëllimit etik) në modelin e Rest (1986). Pra ky punim do të përqendrohet në fazën e tretë të modelit të Rest dhe gjithashtu do të përcaktojë se cili është roli i organizatës në motivimin etik të kontabilistëve duke konkluduar me disa rekomandime në lidhje me këtë çështje.

Pyetja kërkimore dhe metodologjia e punimit.

Në fokus të punimit janë faktorët që ndikojnë në motivimin etik të kontabilistëve të drejtimit. Në këto kushte pyetja kërkimore e cila do të shoqërojë punimin është: Cilat janë faktorët influencues në motivimin etik të kontabilistëve?

Ky punim ndërtohet mbi bazën e një diskutimi teorik në lidhje me tematikën që ai trajton dhe mbështetet në përmbledhjet e literaturës të bëra deri më tani në lidhje me procesin e vendimmarrjes etike në fushën e kontabilitetit. Duke diskutuar teorikisht në lidhje me tematikën e punimit në përfundim të punimit jepet një mendim në lidhje me faktorët që influencojnë motivimin etik të kontabilistëve të drejtimit.

Rëndësia e etikës në profesionin kontabël dhe procesin e vendimmarrjes

Etika e duhur dhe sjellja etike janë shumë të rëndësishme për kontabilitetin për një sërë arsyesh. Kontabilistët shpesh kanë në duar informacionin e ndjeshëm që i përket klientëve të tyre. Kjo i jep kontabilistëve një fuqi të konsiderueshme për sa i përket klientëve të tyre dhe është e rëndësishme që të mos abuzohet me besimin e krijuar midis tyre. Në të njëjtën kohë

është e rëndësishme që edhe industria në vetvete të mos jetë e stigmatizuar si jo etike, gjë që mund të dëmtojë biznesin e të gjithë firmave kontabile. Ruajtja e standardeve etike është një nevojë për çdo sipërmarrje biznesi që ka për qëllim të rezistojë në mënyrë të suksesshme në treg dhe të përmirësojë efeciençën dhe kompetencat e kompanisë në tërësi. Zhvillimi gjithnjë e më tepër i efikasitetit të punonjësve është një aspekt esencial për një organizatë biznesi dhe e ndihmon atë të eci drejt suksesit në mënyrë të vazhdueshme. Kjo kërkon trajnim dhe drejtim të punonjësve në një mënyrë të tillë që të arrihet efikasiteti i performancës së tyre në të gjitha aspektet e biznesit, por njëkohësisht edhe duke e vënë theksin vazhdimisht tek ruajtja e standardeve etike. Të kuptosh dhe të respektosh etikën në biznes është thelbësore për të gjitha aktivitetet e biznesit në përgjithësi.

Përderisa profesioni i kontabilistit lidhet me funksione të ndryshme të kontabilitetit, siç janë regjistrimi i të gjitha ngjarjeve të biznesit të cilat janë me karakter financiar, klasifikimin dhe përmbledhjen e tyre në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, bilancit kontabël dhe pasqyrën e të ardhurave rrjedhëse, mënyra e përmbushjes së këtyre funksioneve është shumë e rëndësishme dhe nevojitet një punë e madhe për të ruajtur etikën e kontabilistëve. Një prej gjërave më të rëndësishme që dëshmon për sjelljen etike të një kontabilisti është fakti që ai duhet të jetë i paanshëm dhe besnik ndaj organizatës së biznesit gjatë kohës kur performon aktivitetet në lidhje me të me sinqeritet dhe me të gjithë ndershmërinë e tij.

Së pari pasqyrat financiare të përgatitura nga kontabilistët të cilat bien në duart e palëve të interesit përdoren dhe kërkohen nga stakeholdera të rëndësishëm në ekonomi për të marrë vendime sa më të drejta në lidhje me investimet. Stakeholderat bazohen në opinionin e kontabilistëve që merren me përgatitjen e këtyre pasqyrave ashtu sikurse edhe tek auditët të cilët i verifikojnë ato, për të krijuar një pamje të drejtë në lidhje me kompaninë. Për këtë arsye kodet janë të rëndësishëm për të siguruar besimin e investitorëve ndaj kompanive.

Njohuritë në lidhje me etikën e kontabilitetit janë të rëndësishme për kontabilistin me qëllim që ai të kapërcejë dilemat etike me të cilat përballlet dhe të udhëhiqet drejt marrjes së vendimeve të drejta të cilat përveç se i sjellin dobi kompanisë, do ti sjellin përfitime gjithashtu edhe publikut i cili bazohet fuqimisht në raportet dhe pasqyrat financiare të ndërtuara prej kontabilistëve. Kjo ndihmon për të parandaluar skandalet të cilat kanë çuar në falimentimin dhe mbylljen e kompanive.

Etika profesionale e kontabilistit është thelbësore në ruajtjen dhe rritjen e besimit për të rritur përgjegjësinë dhe ndjenjën e lartë të integritetit. Integriteti është cilësia prej së cilës varet besimi i publikut dhe shërben si benchmark sipas të cilit vendimet testohen. Etika profesionale i mundëson kontabilistëve të zhvillojnë vlerat e reputacionit, integritetit dhe skepticizmit profesional.

Ekzistenca e Kodeve të forta të etikës dhe zbatimi i rregullave dhe parimeve të tyre krijon siguri në lidhje me investimet, sigurimin e jetës, pensionet etj. Kontabilistët dhe audituesit duhet të zotërojnë një argumentim të fortë për sa i përket gjykimit moral dhe etik si në lidhje me raportimet financiare që ato bëjnë përderisa këto të fundit kanë pasoja thelbësore si tek individët ashtu edhe kompanitë duke ndikuar tërthorazi tregjet e kapitalit dhe humbjet e konsiderueshme të investitorëve të mëdhenj dhe të vegjël.

Etika është mjaft e rëndësishme si për profesionin e kontabilistit ashtu edhe gjatë procesit të vendimmarrjes etike. Duhet theksuar se ekziston një marrëdhënie e ndërsjellë dhe pozitive midis këtyre aspekteve. Në qendër të kësaj marrëdhënie qëndron roli i profesionistëve të kontabilitetit duke qenë se ato janë personat të cilët furnizojnë me informacion të gjitha palët e interesit të një kompanie. Nëse një profesionist kontabël është etik atëherë ai e ushtron profesionin e tij në përputhje me të gjitha parimet e Kodit të etikës dhe kjo siguron që informacioni që ato vënë në dispozicion të përdoruesve të tij është i besueshëm dhe transparent. Duke pasur në dorë një informacion të tillë dhe duke u udhëhequr nga parimet etike këta individë, në duar e të cilëve qëndron drejtimi i kompanisë, kanë të gjitha mundësitë për të ndërmarrë një proces vendimmarrje etik. Procesi i vendimmarrjes është një proces shumë i rëndësishëm për një kompani duke qenë se ai është faktori kryesor që e çon atë drejt suksesit për vetë faktin se marrja e vendimeve etike do të thotë performancë e lartë jo vetëm në terma afatshkurtër por edhe afatgjatë. Sa më etik të jenë kontabilistët e një kompanie në ushtrimin e kompetencave të tyre aq më i besueshëm, i saktë dhe relevant është informacioni i prodhuar prej tyre. Sa më e lartë të jetë cilësia e informacionit në duart e vendimmarrësve aq më të mëdha janë shanset për të marrë vendime etike. Sa më etike të jenë vendimet që merr një kompani aq më e lartë është performanca e saj.

Modeli i Rest në lidhje me procesin e vendimmarrjes etike

Procesi i vendimmarrjes së çdo individi lidhur me një çështje të caktuar është një proces i vështirë dhe i komplikuar, duke qenë se secili prej nesh duhet të marrë parasysh disa faktorë dhe rrethana specifike në momentin kur e merr këtë vendim. Akoma edhe më i vështirë dhe kompleks është ky proces në rastin e kontabilistëve të drejtimit të cilët marrin vendime mjaft të rëndësishme në lidhje me njësinë që ato drejtojnë, vendime këto nga të cilat varet performanca dhe vijimësia e saj.

Kuadri teorik i hartuar nga Rest (1979,1986) cilësohet si një nga shkrimet më të rëndësishme lidhur me procesin e vendimmarrjes brenda organizatës. Ai propozon një proces i cili kalon në katër etapa të cilat janë:

- njohja etike-aftësia për të dalluar nëse kemi të bëjmë me një situatë etike ose jo.
- gjykimi etik-aftësia për të vendosur se cila mënyrë veprimi është e drejtë.
- qëllimi etik-aftësia për ti dhënë prioritet alternativave etike kundrejt alternativave të tjera.
- sjellja etike-aftësia për të ndërmarrë sjellje etike.

Rest argumenton që secila fazë apo etapë është konceptualisht e ndryshme dhe se suksesi në një fazë nuk do të thotë domosdoshmërisht sukses edhe në fazën tjetër. Që prej vitit 1980 pjesa më e madhe e studimeve dhe e modeleve mbi vendimmarrjen në fushën e biznesit janë bazuar fuqimisht mbi strukturën e Rest. Kërkuesit e biznesit të fushave të ndryshme si marketing, auditimi, dhe manaxhimi dhe nga vende të ndryshme e kanë adaptuar këtë strukturë në kërkimet e tyre. Ndonëse disa prej tyre kanë analizuar vetëm një fazë të këtij procesi disa të tjerë janë marrë me studimin e dy ose më shumë fazave. Në vijim do të bëhet një përshkrim i shkurtër i secilës etapë në të cilën kalon procesi i vendimmarrjes etike sipas këtij modeli.

1-Njohja etike

Njohja etike është faza e parë e modelit të ndërtuar nga Rest (1986) dhe sipas studiuesve të ndrydhëm është faza më kryesore dhe vendimtare e këtij procesi duke qenë se ajo ndihmon në fillimin e vendimmarrjes etike.

Butterfield et al(2000,fq.988) e përkufizon njohjen etike si “ndërgjegjësimi i një individi që vendimi ose veprimi potencial i tij/saj mund të influencojë interesin, mirëqenien ose pritshmëritë e vetes edhe të tjerëve në një mënyrë që mund të jetë në konflikt me një ose më shumë parime etike.” Sikurse vihet re nga ky përkufizim tre janë pikat kyçe të kësaj etape:

njohja e vendimmarrësit,
vendimi ose veprimi dhe
individët që do të ndikohen.

I rëndësishëm për tu përmendur është edhe qëndrimi i Rest i cili thotë se procesi i vendimmarrjes etike fillon në momentin kur një individ kupton se situata që i paraqitet ka të bëjë me një çështje etike ose një parim etik duhet të aplikohet për ta zgjidhur atë. Ai argumenton që aftësia për të identifikuar dhe vlerësuar çështjen etike në një situatë është një kusht paraprak i nevojshëm për vendime etike të drejta.

Rezultatet e studimeve empirike dëshmojnë se studentët e kontabilitetit të cilët i kanë njohur më parë standardet etike në lidhje me profesionin e tyre i kanë perceptuar më mirë krahasuar me studentët e kontabilitetit të cilët nuk i kanë njohur më parë këto standarde. Vlen të përmendet se ballafaqimi me çështjet etike është i nevojshëm por jo i mjaftueshëm për të ndryshuar sjelljen etike të individëve.

2-Gjykim etik

Gjykimi etik përbën fazën e dytë të procesit të vendimmarrjes dhe cilësohet si një ndër fazat më të rëndësishme të tij. Sipas Trevino (1986) gjykimi etik ka të bëjë me procesin gjatë të cilit një individ përcakton cili kurs veprimi është moralisht i drejtë ose i gabuar. Elementi më i rëndësishëm i kësaj etape konsiston në përdorimin e aftësive njohëse të vendimmarrësit në momentin që ai përballet me një dilemë etike dhe duhet të përcaktojë çfarë është e drejtë dhe e gabuar. Të vendosurit midis asaj që është e drejtë dhe asaj që është e gabuar është elementi më vital në fazën e gjykimit etik pasi në rastet kur individ i nuk bën zgjedhjen e duhur midis të drejtës dhe të gabuarës në momentin e duhur atëherë gjykimi i tij individual nuk mund të shpjegohet si etik (Murphy, 2007).

3-Qëllimi etik

Faza e tretë e procesit të vendimmarrjes etike në modelin e Rest(1986) është qëllimi etik. Nëse një individ ka bërë një gjykim etik, ai/ajo formulon një qëllim për tu sjellë në mënyrë etike bazuar në vlerësimin e zgjidhjes së drejtë kundrejt zgjidhjeve të tjera (Sweeney&Costello, 2009).

Sipas Rest (1986) motivimi ose qëllimi etik është shkalla e angazhimit për të ndjekur kursin moral të veprimit, duke vënë vlerat morale mbi vlerat e tjera, dhe duke marrë përsipër përgjegjësitë personale për rezultatet morale(Armstrong et al.,2003). Ai argumenton që qëllimi i individëve për tu sjellë në mënyrë etike, madje edhe në kurriz të interesave të tyre, mund të rrjedhë nga gjëra të ndryshme si turpi, normat sociale, ndjeshmëria e lartë, kujdesi, afeksioni dhe vetë-integriteti. Kështu, në këtë fazë, individ duhet të peshojë vlerat etike kundrejt vlerave të tjera për të krijuar qëllimin etik(Jones,1991;Rest,1986).Për më tepër, mangësitë në qëllimet etike mund të çojnë në sjellje jo etike. Në modelet më zakonshme të vendimmarrjes etike (Hunt&Vitell,1986;Jones,1991;Rest,1986) që janë ndërtuar, vendosja e qëllimeve etike është vitale (Sweeney&Costello.2009). Në modelin e Hunt & Vitell qëllimi etik konsiderohet si variabël përfundimtar më i rëndësishëm i influencuar nga gjykimi etik dhe teologjia e veprimit. Në mënyrë të ngjashme, në modelet e Rest & Jones qëllimi etik është rezultati përfundimtar, i ndikuar nga gjykimi etik.

4-Sjellja etike

Faza finale e procesit të vendimmarrjes etike është sjellja etike. Ajo ka të bëjë me momentin kur një individ angazhohet në një veprim të caktuar si rezultat i qëllimit të tij. Sjellja etike përkufizohet si diçka që është moralisht dhe ligjrisht e pranueshme nga komuniteti i gjerë (Jones, 1991,p.367). Rest(1986)sugjeron që sjellja etike është rezultat i një procesi kompleks dhe të shumëfishtë. Edhe pse shumë kërkues sugjerojnë që ka nevojë për më shumë kërkime empirike lidhur me sjelljen etike, disa prej tyre argumentojnë se sjellja etike nuk është e thjeshtë për tu studiuar për shkak të natyrës së saj ndjeshme dhe vështirësive në matjen dhe observimin e saj pa paragjykim (Ampofo, Mujtaba, Cavico & Tindall,2004).

Shjelljet jo etike të kontabilistëve shqiptar dhe faktorët që ndikojnë në to

Dokumentacioni financiar pasqyron informata të rëndësishme për vendimmarrjen e investitorëve. Nëse ai dokumentacion përmban informata jo korrekte, këto veprime janë joligjore dhe jo etike, prandaj janë të sanksionuara me ligj dhe konsiderohen si krime. Masat disiplinore variojnë nga këshillimi deri në fshirjen përhershme nga regjistri publik, e cila përmban ndalimin përgjithmonë të ushtrimit të profesionit.

Shkelje që kanë të bëjnë me shjelljen jo etike nga kontabilistët e njëjësive ekonomike ndeshen shumë edhe në praktikën e biznesit shqiptar. Por sigurisht që shumica e kontabilistëve e ushtrojnë profesionin në mënyrë të ndershme duke zbatuar rregullat e Kodit të etikës. Në këtë të fundit janë përcaktuar qartë veprimtaritë etike dhe ato që konsiderohen si të papajtueshme në lidhje me ushtrimin e profesionit të EKR-së.

Kontabilisti e ka për detyrë të paraqesë një pamje të vërtetë të gjendjes financiare të njësisë ekonomike. Por në kushtet e Shqipërisë, ku shkalla e informalitetit të ekonomisë është e lartë, paraqet probleme përgatitja e pasqyrave financiare pa anësi. Në praktikën e përditshme, në shumë raste, i shohim kontabilistët të vihen nën presion nga audituesit apo administratorët e njësisë ekonomike, për të fshehur ose mbivlerësuar elementë të veçantë të pasqyrave financiare. Kjo trysni ushtrohet për t'i paraqitur këto pasqyra në banka për të përfutur kredi, dhe në zyrat e tatim-taksave për të zvogëluar detyrimet fiskale. Etika në këtë profesion, kërkon që kontabilisti të mos tërhiqet para mashtrimeve edhe kur është nën presion.

Sistemi bankar është vetë fajtor për rritjen e kredive të këqija, sepse kërkon nga shoqëritë jo bilancin që dorëzohet në organin tatimor por bilancin mashtrues. Shoqëritë të detyruara nga nevojat për likuiditet për vazhdimësinë e biznesit, detyrohen të mashtrojnë bankat me bilance fallso dhe bankat mbyllin sytë para kësaj gënjeshtre. Ky lloj pranimi lidhet me shpërblimet që përfitojnë drejtuesit e bankave për çdo kredi të dhënë.

Kjo praktikë të vepruari mund të vërë në rrezik aktivitetin e bankës dhe tërë sistemin financiar në Shqipëri. Prandaj, bankat e niveleve të dyta në rastet e dhënies së kredive, përveç garancive të detyrueshme që kërkojnë, duhet të verifikojnë dhe bilancet dhe pasqyrat e tjera financiare që depozitohen pranë Zyrave të Tatim-Taksave. Nevojitet që edhe Banka e Shqipërisë të bëjë ndërhyrjen e saj sa më shpejt për të shpëtuar sistemin nga prodhimi i bilanceve me shifra false.

Një koordinim i mirë mes të dhënave që dorëzohen shoqëritë në zyrën e tatimeve, dhe të atyre që ofrojnë në bankat e nivelit të dytë, do të bëjë atë që kompanitë të mos fshihen më, por të dalin me gjendjen e tyre financiare reale.

Në kuadër të Kodit etik, kontabilisti duhet të mbrojë interesat e klientit të tij duke përmbushur përgjegjësitë e tij. Të vepruarit me ndershmëri etike, është një e drejtë dhe detyrim i kontabilistit, ndaj besimit që i është dhënë për të pasqyruar me vërtetësi informacionin financiar në interes të publikut. Në këtë këndvështrim, përgjegjësia e kontabilistit nuk shtrihet vetëm ndaj atij që e paguan por edhe ndaj përdoruesve të informacionit kontabël: shtetit, bankat, tatimeve, gjykatave etj.

Siç ka ndodhur në disa raste në Shqipëri, të mbrosh interesat e njësisë së biznesit nuk do të thotë të hysh në pazare me inspektorët tatimorë për shkelje të paqena të ligjit tatimor, me interes të dyanshëm, ku janë penalizuar edhe inspektorët edhe kontabilistët, por të mbrosh klientin duke mos e rënduar atë me detyrime apo penalitete për tatime. Raste të tilla u ndeshën përpara periudhës së zgjedhjeve qeveritare gjatë vitit 2013, ku shumë biznese u ngarkuan nga organet tatimore me detyrime tatimore të paqena dhe në kundërshtim me ligjin. Më pas këto detyrime u anuluan me vendim të qeverisë së re të ardhur në pushtet. Kjo është detyrë dhe e drejtë e çdo kontabilisti që të kërkojë në organet përkatëse ndryshimin e masës së taksave kur besojnë se ato janë të padrejta.

Kohët e fundit në Shqipëri ka ndodhur që kontabilistë apo auditues bilanci, të jenë të motivuar vetëm nga interesi vetjak, dhe t'i përdorin njohuritë e tyre për përfitime jo të drejta. Ata përgatisin bilance apo edhe i certifikojnë ato pa verifikuar dokumentet, si faturat, arkëtimet, pagesat etj., pa bërë rakordime me klientët, furnitorët, bankat për kreditë e marra apo për interesat e paguara etj., por thjesht duke përdorur pasqyrat përmbledhëse të TVSH-së, të pagave, totale e të hyrave e të dalave të bankës, të arkës etj. Madje as gjendja e inventarit dhe i aktiveve afatgjata, nuk verifikohen nëse janë faktikisht apo jo.

Nga praktikat e hartimit të bilancit dhe auditimit të tyre, konstatohet se jo pak profesionistë të kontabilitetit nuk po tregojnë seriozitetin e duhur as në hartimin e bilancit, as në auditimin e tij. Aq më tepër në Shqipëri, që arrihet deri atje sa bilancet dhe pasqyrat financiare i hartojnë jo profesionistët, deri edhe inspektorët e tatimeve. Nga një vrojtim i kohëve të fundit, inspektorët e tatimeve sidomos në rrethe, por edhe në Tiranë, hartojnë rreth 60 % të bilanceve vetë apo me njerëz të tyre, që hapur është konflikt interesash.

Pavarësia e profesionit të kontabilistit ruhet duke shmangur në çdo rast konfliktin e interesit. Nuk mund të bësh dy punë, njërën ta deklaroësh, siç mund të jetë auditimi, dhe tjetrën, kontabilitetin, mbajtjen e kontabilitetit, nxjerrjen e bilancit, ta fshehësh, sikur këtë e ka bërë dikush tjetër, por që në fakt dikush ka vënë vetëm firmën. Kështu ndodh rëndom në Shqipëri, dhe nuk është e rastit, që për një periudhë 2-3 mujore, nga janari në mars (periudha e mbylljes së bilancit), një kontabilist harton 120-150 bilance të bizneseve të ndryshme. Duket mjaft qartë, që thjesht duke analizuar termat kohorë të përmbushjes së këtij misioni, edhe kontabilisti me më shumë eksperiencë nuk mund të ndërtojë pasqyra financiare cilësore dhe jo më të sigurojë se ka punuar me integritet.

Inspektorët të tillë tatimorë dhe kontabilistët që furnizohen me klientë nga ata duhen pezulluar nga ky shërbim, pasi cenojnë besimin në profesionin e kontabilitetit. Për të parandaluar këto fenomene negative, organet përkatëse ligjore duhet të godasin fort duke luftuar konkurrencën e pandershme dhe monopolizimin e këtij tregu nga një rreth i ngushtë personash. Gjithashtu ky fenomen mashtrues duhet të luftohet edhe nga organizatat profesionale që operojnë në Shqipëri, duke vendosur rregulla të forta loje që të sigurojnë në çdo kohë transparencën e këtij aktiviteti dhe mirëfunksionimin e ekonomisë së tregut.

Etika është mjaft e rëndësishme dhe në kontabilitetin e taksave, sidomos në kushtet e Shqipërisë ku sistemi ynë i taksave ka në thelb vetëdeklarimin. Në çdo legjislacion fiskal mund të thuhet se ka hapësira për tu shfrytëzuar nga tatimpaguesit për të paguar më pak tatime e taksa, por në Shqipëri gjatë këtyre viteve është krijuar kultura e biznesit për t'ju shmangur sa më shumë këtyre pagesave. Aq sa dhe informacionet që Banka Botërore ka nga auditimet flasin për një evazion deri në 66% të të ardhurave të buxhetit. Prandaj, për të funksionuar me efektivitet sistemi i vetëdeklarimit është e nevojshme që të gjithë tatimpaguesit të respektojnë Kodin e etikës duke deklaruar me ndershmëri të ardhurat e tyre për të përcaktuar me korrektësi detyrimet tatimore.

Sidoqoftë, profesionistët kontabël nuk duhet të shfrytëzojnë avantazhet e ligjit tatimor për të vepruar në mënyrë jo etike duke u përfshirë në skema mashtrimi me taksat. Raste të tilla mashtrimi janë përdorimi i faturave fiktive nga bizneset për të paguar më pak TVSH dhe të rekomanduara nga disa kontabilistë, në mënyrë që këta të fundit të përfitojnë honoraret e tyre të paligjshme prej 10 % së shumës së TVSH-së së reduktuar.

Edhe pse tatimpaguesit shpesh përzgjedhin tu shërbejnë kontabilistët që u premtojnë se do të paguajnë më pak tatime e taksa, kjo konsiderohet si një rrugëzgjdhje afatshkurtër. Praktikant kanë dëshmuar se jo pak kontabilistë i kanë ndërprerë marrëdhëniet me biznesin brenda një kohe të shkurtër pasi shkëljet janë zbuluar nga kontrollet tatimore dhe biznesi është penalizuar me gjopa të mëdha. Prandaj është e nevojshme të zgjidhen kontabilistë që jo vetëm janë etikë por që angazhohen të sigurojnë që klientët e tyre operojnë në mënyrë etike gjatë gjithë kohës.

Faktorët që ndikojnë në motivimin etik të kontabilistëve

Edukimi etik i cili në vetvete përfshin dimensionet e ndjeshmërisë etike dhe gjykimit etik të modelit të Rest jo domosdoshmërisht siguron sjelljen etike (Hajjaë, 2008; Armstrong, 2003; Zengin et al., 2009). Rritja e ndjeshmërisë morale është e nevojshme për sjelljen etike por jo e mjaftueshme. Në kontekstin e etikës në kontabilitet, pjesa më e madhe e studimeve janë përqendruar në fazën e njohjes dhe gjykimit etik duke lënë mënjanë gatishmërinë individuale që përbën një faktor kryesor në angazhimin në vendimmarrje etike. Në këtë këndvështrim është e dobishme analiza e mënyrave të cilat zhvillojnë motivimin etik të kontabilistëve dhe njëkohësisht edhe përcaktimi i faktorëve që kontribuojnë në motivimin etik të kontabilistëve.

Sipas rezultateve të arritura nga kërkimet e deritanishme tre janë faktorët kryesor që ndikojnë në motivimin etik të kontabilistëve (Shaub et al., 2005). Në vazhdim të këtij punimi do të diskutohen këto faktorë influencues mbi motivimin etik të kontabilistëve dhe në të njëjtën kohë do të shpjegohet edhe lidhja midis këtyre faktorëve dhe etapës së motivimit etik të modelit të Rest.

1-Motivimi i vetë-interesit.

Një pjesë e konsiderueshme e literaturës, ashtu sikurse edhe vërtetimet rastësore, mbështesin fuqimisht idenë se individët veprojnë sipas interesit të tyre vetjak. Kjo pikëpamje, e cila siguron suportin kryesor të teorisë së tregut ekonomik, është eksploruar në literaturën e etikës së kontabilitetit nëpërmjet studimit të “teorisë së pritjeve”. Sipas kësaj teorie, individët i kalkulojnë në mendjet e tyre gjasat që rezultate të ndryshme mund të merren si rezultat i veprimeve të tyre dhe probabilitetin e arritjes së këtyre rezultateve (Grant & Ashford, 2008). Në përgjithësi individët zgjedhin të angazhohen në veprime apo sjellje të cilat maksimizojnë rezultatet pozitive dhe minimizojnë ato negative. Kjo është arsyeja pse interesi vetjak njihet në mënyrë të natyrshme si një prej stimuljeve që ndihmojnë në motivimin e sjelljes menaxheriale. Pavarësisht faktit se paraja njihet si një prej shpërblimeve më të lakmuara nga individët duhet pranuar fakti se ajo posedon fuqinë për të induktuar si sjelljen pozitive ashtu edhe atë të korruptuar. Përtej parasë, sipas kërkimeve të bëra në fushën e kontabilitetit arrihet në përfundimin se individët vlerësojnë edhe mënyra të tjera shpërblimi të tilla si statusi i tyre, siguria në punë, dhe promovimi potencial (Royae & Mohammadi, 2011; Shaub et al., 2005). Interesi vetjak është një element i rëndësishëm në motivimin e kontabilistëve.

2-Kujdesi për të tjerët.

Pavarësisht faktit se literature pranon se interesi vetjak është një forcë e rëndësishme në zgjedhje, ka fakte që dëshmojnë se njerëzit nuk veprojnë gjithmonë sipas interesit të tyre vetjak gjë që ka intriguar kërkuesit e disiplinave të ndryshme. Natyrisht që të kesh në konsideratë interesin e të tjerëve është në zemër të etikës (Mathenge, 2012). Pjesa më e madhe e teorisë të vendimmarrjes etike marrin në konsideratë një komponent që shkon përtej kalkulimit të shpërblimeve të jashtme apo pasojave të një vlerësimi të brendshëm bazuar në ndjenjën e detyrës ose të një mësimi fetar. Ky fakt është në përputhje me argumentin se morali i individëve mund të influencojë motivimin në punë kështu që është një komponent i cili duhet të përfshihet në modelin e pritjeve (Shaub et al., 2005). Kujdesi ndaj të tjerëve ka të bëjë me afritetin e një personi me të tjerët dhe dhembshurinë e këtij individ për të tjerët. Në thelb ky nocion është i kundërt me atë të interesit vetjak. Nga njëra anë qëndron interesi vetjak dhe nga ana tjetër qëndron kujdesi për të tjerët. Konflikti i interesit në procesin e vendimmarrjes ka të bëjë me ndërtimin apo përballjen me sfidat dhe në këtë këndvështrim është vendimmarrësi ai që duhet të bëjë një zgjedhje midis interesit vetjak apo kujdesit të ndaj të tjerëve.

3.Pagesat direkte dhe indirekte.

Pagesat direkte dhe indirekte përfaqësojnë një variabël direkt i cili përforcon kurajon e çdo individ për tu përfshirë në vendime financiare apo kontabile të dyshimta dhe jo etike (Shaub et al., 2005). Rastet e bujshme të kompanive të mëdha si

Enron apo EorlCom të cilat dështuan ndër të tjera edhe si rezultat i vendimeve jo etike të marra prej menaxherëve të tyre faktojnë që pagesat apo shpërblimet luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e sjelljeve jo etike. Kështu pagesat dhe roli i tyre në stimulimin e sjelljeve jo etike janë vlerësuar si një faktor i pakundërshtueshëm.

Roli i organizatave në motivimin etik të kontabilistëve të drejtimit

Etika përbën një faktor të një rëndësie të pamohueshme për profesionin e kontabilistit të drejtimit. Duhet theksuar se mësimi dhe edukimi i etikës tek individët jo domosdoshmërisht siguron sukses në lidhje me ushtrimin e sjelljeve etike dhe në të njëjtën kohë nuk mund të pretendohet se studentët e kontabilitetit, të cilët përfaqësojnë kontabilistët e ardhshëm, do të jenë të aftë të trajtojnë siç duhet dilemat etike me të cilat ato do të përballen gjatë ushtrimit të profesionit të tyre vetëm në sajë të faktit se gjatë kohës së studimit në universitete ato janë trajnuar dhe janë përballur në lidhje me njohjen dhe zgjidhjen e dilemave të ndryshme etike. Arritja e një kompetence të lartë profesionale nuk është vetëm përgjegjësi individuale e çdo kontabilisti por ajo varet edhe nga puna në vijimësi e shoqatave profesionale që operojnë në Shqipëri, si IEKA, IKM-ja dhe SHKFSH-ja, duke ofruar programe trajnimi në përputhje me të rejat e profesionit. Ndërsa shoqatat profesionale e kanë përqendruar punën e tyre në përgatitjen dhe mësimin e standardeve etike nga ana e profesionistëve, rolin të organizatave në nxitjen dhe motivimin drejt vendimarrjes etike të punonjësve të tyre, edhe pse një faktor shumë i rëndësishëm, i është kushtuar një vëmendje e vogël. Sipas Bampton & Coëton (2002) programet e shoqatave profesionale në lidhje me edukimin e vazhdueshëm profesional mund të forcojnë standardet që shoqëria vlerëson dhe që në të njëjtën kohë janë të rëndësishëm për mirëfunksionimin e tregut të kapitalit. Në të njëjtën kohë Kodi i Etikës ofron disa udhëzime dhe ofron zgjidhjet e mundshme në lidhje me disa situata specifike. Duhet theksuar se përveç hartimit të Kodit këto organizata duhet të motivojnë kontabilistët në përgjithësi dhe ato të drejtimit në veçanti duke qenë se ato janë të përfshirë direkt në vendimarrje. Këto shoqata profesionale janë organizmat e vetme të cilat nëpërmjet punës intensive mund të formojnë leadership në këtë periudhë delikate të profesionalizmit. Profesionin e kontabilistit përballet me sfidën nëse vlerat etike mund të mësohen pasi individit i bashkohet një organizatë apo është organizatë ajo që duhet ti besojë kontroleve të brendshme për të parandaluar dhe identifikuar sjelljen jo etike (Shaub et al., 2005). Ekziston një debat i hapur në lidhje me rëndësinë e vlerave profesionale, personale dhe organizative të cilat kanë potencialin për të bërë ndryshimin në periudha afatgjata në aftësinë e kontabilistëve të drejtimit për të hequr dorë nga sjelljet jo etike (IMA, 2008). Organizatat mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në motivimin e kontabilistëve të drejtimit. Bazuar në faktorët influencues të cilët u shpjeguan më lart, do të analizohen udhëzimet të cilat mund të implementohen prej organizatave të ndryshme. Rekomandimet në lidhje me këtë çështje janë si më poshtë:

Çdo organizatë duhet të jetë e vetëdijshme dhe të pranojë faktin se interesi vetjak është një komponent që ndikon të gjithë individët, përfshirë këtu edhe kontabilistët e drejtimit. Arsyeja primare e cila i shtyn individët drejt ushtrimit të sjelljeve jo etike është fakti që prej një sjellje të tillë ky individ i cili e ndërmerret një sjellje të tillë mund të marrë prej saj përfitime në forma të ndryshme. Në çdo rast kur kontabilistët e drejtimit nuk janë të shpëputur financiarisht ose emocionalisht nga përfshirja në sjellje të tilla, interesi vetjak ka shumë gjasa që të ndikojë zgjedhjet e tyre (Shaub et al., 2005). Për këtë arsye organizatat duhet të përpiqen që të kënaqin kontabilistët e drejtimit të cilët punojnë për to si nga ana financiare ashtu edhe nga ana emocionale.

Sjellja etike e kontabilistëve të drejtimit ndikohet në një masë të konsiderueshme nga vlerat personale, organizative dhe ato personale. Për sa i përket vlerave personale dhe veçanërisht kujdesi që një individ ka ndaj të tjerëve, bëjnë që ky individ të jetë më pak i prirur për tu përfshirë në sjellje jo etike (Shaub et al., 2005). Punëdhënësit duhet të inkurajojnë sa më shumë të jetë e mundur kontabilistët e drejtimit që të marrin në konsideratë pasojat që vendimet e tyre kanë tek palët e treta, si brenda ashtu edhe jashtë organizatës. Në të njëjtën kohë është e rëndësishme të theksohet se këto organizata duhet të inkurajojnë zhvillimin e vlerave personale të cilat frenojnë sjelljen jo etike dhe promovojnë sjelljen etike brenda organizatës (Armstrong, 2003).

Adaptimi i vlerave organizative të cilat sugjerohen nga standardet etike të ushtrimit të profesionit dhe njëkohësisht nga literatura mund të përforcojë idenë se ekziston edhe diçka tjetër përveç interesit vetjak që ka fuqinë për të parandaluar përfshirjen e punonjësve në sjellje jo etike (Rayae & Mohammadi, 2011; Shaub et al., 2005; Mathenge, 2012).

Që të gjitha këto që u diskutuan deri më tani të marin formën e duhur dhe të jenë konkrete duhet që të paktën çdo organizatë të ndërmarrë katër hapat e mëposhtme:

Të shprehë qartë vlerat etike të punonjësve të saj.

Të kuptojë sic duhet vlerat etike të punonjësve të saj gjatë procesit të marrjes në pinë dhe promovimit të tyre në mënyrë që të sigurohet se ekziston një lidhje adekuate midis vlerave individuale dhe atyre organizative.

Një prej faktorëve më të rëndësishëm organizativ është shkalla e përfshirjes së liderëve të organizatës në leadershipin etik (Royae & Mohammadi, 2011). Është e rëndësishme që të gjithë drejtuesit të ndjekin shembullin e një lideri model të vendosur në krye të organizatës.

Shpërblimi i punonjësve të cilët i mbartin këto vlera dhe njëkohësisht ndëshkimi i atyre individëve të cilët nuk i respektojnë vlerat etike nëpërmjet një ndëshkimi publik në mënyrë që secili të kuptojë siç duhet mesazhin.

Konkluzione

Bazuar në rëndësinë e informacionit të hartuar nga ana e kontabilistëve, është e natyrshme të bihet dakord se çdo kontabilist duhet të ushtrojë profesionin e tij duke pasur gjithmonë parasysh standardet etike të profesionit. Shoqatat profesionale I janë përgjigjur këtyre nevojave duke hartuar Kodin e Etikës I cili shërben si një udhëzues për profesionistët sa herë që ato përballen me dilema të ndryshme etike. Në sajë të literaturës së deritanishme në fushën e etikës së kontabilitetit mbështete fakti se edukimi I etikës është shumë I rëndësishëm për profesionistët e kontabilitetit por i vetëm ai nuk siguron gjithmonë sukses në zgjidhjen e dilemave të ndryshme etike me të cilat përballen kontabilistët. Bazuar në modelin e Rest në lidhje me procesin e vendimmarrjes etike, motivimi etik luan një rol të pa kundërshtueshëm në shfaqjen e sjelljeve etike. Motivimi etik i kontabilistëve mund të nxitet si nga ana e organizatës për të cilën ai punon por njëkohësisht edhe nga shoqatat profesionale të cilat kanë për qëllim rregullimin e profesionit të kontabilistit.

Rekomandime

Kontabilisti shpesh i dorëzohet presionit për të bërë biznes gjithnjë e më fitimprurës duke hequr dorë nga profesionalizmi i tij. Nisur nga ky këndvështrim kritik, motivimi i kontabilistëve drejt vendimmarrjes etike është dhe do të mbetet në dorën e shoqatave profesionale të cilat rregullojnë këtë profesion në vendin tonë. Këto shoqata duhet të marrin masa në lidhje me problemet e poshtë përmendura për të kthyer edhe një herë besimin e publikut ndaj profesionistëve të kontabilitetit.

Edukimi i vijueshëm i kontabilistëve është dhe mbetet kritik, prandaj shteti duhet të inkurajojë përfshirjen e më shumë çështjeve etike në trajnimet e detyrueshme . Kjo do të rrisë vizibilitetin dhe do të promovojë një shpërndarje më të madhe të vetëdijes etike. Gjithashtu në Shqipëri i duhet larguar dhe praktikës së ndjekur shpesh për të shmangur formalisht konfliktin e interesit, që audituesi i pasqyrave financiare të hartojë bilancin dhe t'ia japë thjesht për firmë dikujt tjetër, një kontabilisti të miratuar. Pra audituesit nuk duhet të shfaqen si të pavarur por të jenë vërtetë të tillë në punën e tyre. Kriza financiare, falimentimi i njësive ekonomike dhe dështimi i kontabilistëve kanë treguar se shkelja e parimit të pavarësisë mund të ketë pasoja të mëdha jo vetëm në tregjet e kapitalit por mund të shoqërohet dhe me krizë të besimit në profesionin e kontabilistit.

Në zbatim të standardeve etike, profesionisti kontabël duhet t'i rekomandojë njësisë së biznesit rrugën e duhur për të mos u përfshirë në skema mashtrimi dhe abuzimi që do të ishin në dëm të të dyja palëve. Nëse gjatë angazhimit të tij ngrihen pyetje etike, një memo duhet t'i paraqitet klientit bashkangjitur në hollësi se si janë zgjidhur çështjet apo t'i parashtrihen të gjitha argumentet bindëse dhe pasojat e veprimeve jo etike nëse ato do të ndërmerreshin. Nëse klienti nuk bindet atëherë sjellja më etike e kontabilistit do të jetë të tërhiqet nga misioni i tij.

Shkeljet e ndodhura në Shqipëri me rimbursimin e TVSH-së me fatura fiktive apo bilancet e rreme të përgatitura nga kontabilistët dhe që i paraqiten bankave për kredi na bëjnë të pranojmë që edhe profesioni i kontabilitetit tundohej nga përfitimi i të ardhurave të majme për të manipuluar shifrat. Qeveria duhet të vazhdojë të luftojë fort evazionin fiskal, duke mbyllur mjaft hapësira për mundësi mashtrimi në sistemin fiskal. Nga ana tjetër vetë kontabilistët nuk duhet të shfrytëzojnë këto avantazhe në mënyrë abuzive për t'i sugjeruar biznesit që të paguajë më pak taksë e tatime. Këto sjellje jo etike nuk duhet të vazhdojnë më në Shqipëri sepse po rrezikojnë komprometimin e besimit të publikut ndaj këtij profesioni.

Të vepruarit në mënyrë etike kërkon shumë më tepër se një kod të sjelljes. Qasja "e mos të shikuarit dhe mos të treguarit të shkeljeve" është e destinuar për të shkatërruar reputacionin e kontabilistit dhe njësisë ekonomike. Standarde të larta duhet të zbatohen me një politikë të tolerancës zero.

Rregullatorëve duhet t'i jepet më shumë pushtet për të zhvilluar praktika etike në kontabilitet. Është e nevojshme të veprohet mbi baza të rregullta kundër shkelësve të standardeve të kontabilitetit për të siguruar transparencën në dërgimin dhe marrjen e informacionit financiar. Rregullatorët duhet të vënë në jetë shembuj të mbylljes së disa shoqërive kontabiliteti për shkak të praktikave të tyre jo etike, pasi është vështirë të gjendet ndonjë kontabilist i pandershëm që të ndëshkohet.

Së fundi, qëllimi kryesor i biznesit nuk duhet ngatërruar, në çdo rast në plan të parë duhet të jetë ofrimi i një shërbimi cilësor në të mirë të shoqërisë dhe jo rritja e përfitimeve sa më shumë të jetë e mundur. Një kontabilist nuk duhet t'i lejojë vetes që të bëhet shumë i varur nga një klient ose të bëhet aq shumë i varur financiarisht sa që nuk mund të përballojë zvogëlimin e të ardhurave që mund të rezultojnë nga ndërprerja e marrëdhënies me klientin për shkak të një problemi të etikës.

Adoptimi i rekomandime të mësipërme, do të përfaqësonte një hap drejt kthimit të besimit në një profesion që nuk mund të funksionojë pa besimin e publikut.

Bibliografia

- Amat, O, Blake, J, Dowds, J (1991), "The Ethics of Creative Accounting", Journal of Economic Literature Classification: M41.,
Armstrong, M.B (1993), "Ethics and Professionalism in Accounting Education: A Sample Course", Journal of Accounting Education, Elsevier.
Armstrong, M.B (2003), "Ethics Education in Accounting: Moving toward Ethical Motivation and Ethical Behavior". Journal of Accounting Education, Elsevier, 1-16.
Bampton, R, J. Cowton, C, (2002) "Pioneering in Ethics Teaching: The Case of Management Accounting in UK Universities", SPRINGER, 279-295.

- Brands, K, (2010) "Teaching Ethics and Value in Accounting Courses". 13th Annual Colleagues in Jesuit Business Education Conference.
- Fulmer, W. E, Cargile, B. R, (1987) "Ethical Perception of Accounting Student: Does Exposure to a Code of Professional Ethics Help?". Issues in Accounting Education.
- Gough, R. W, (1998) "Character is density: The Value of Personal Ethics in everyday Life" Rocklin, CA: Prima Publishing.
- Grant, A. M, Ashford, S. j, (2008), "The Dynamic of Reactivity at Work", ELSEVIER.
- Hajjawi, O, (2008) "Pioneering in Teaching Business Ethics: The Case of Management Accounting in Universities in Palestine", European Journal of Economics, Finance and Administrative Sciences, 149-158.
- Institute of Management Accountants (IMA), (2008), "Values And Ethics: From Inception to Practice", Published by IMA.
- Kohlberg, L (1984), "The Psychology of Moral Development". San Francisco: Harper & Row.
- Larsen, E, J (1997). Modern Advanced Accounting-review Q & exr.
- Loeb, S. E, (1988), "Teaching Students Accounting Ethics: Some Critical Issues". Issues in Accounting Education.
- Mathenge, G. D, (2012) "Ethical Dimensions in Responsible Professionalism and Accounting Procedures in Kenya: A Critical Analysis of Theory and Practice", Research Journal of Finance and Accounting, Vol 3, No 2, 58-69.
- Mintz, S. M, (1992) "Cases in accounting ethics and professionalism" (2nd ed.), New York, NY: McGraw- Hill.
- Reidenbach, R. E. and D. P. Robin, (1990) "Toward the Development of a Multi-dimensional Scale for Improving Evaluations of Business Ethics". Journal of Business Ethics 9.
- Rest, J (1986) "Moral Development: Advances in Research and Theory". New York: Praeger.
- Royace, R, Mohammadi, M, (2011). Ethics & Professionalism in Accounting.
- Shaub, K et al (2005.) "Self-Interest vs. Concern for Others", Annual Conference Topic Ethics, 41-46.
- Taicu, M (2007) "Ethics in Management Accounting", Scientific Bulletin- Economic Science. Vol.9.
- Thorne, L (1998), "The Rile of Virtue in Auditors' Ethical decision making: An Integration of Cognitive-developmental and Virtue-ethics Perspectives". Research on Accounting Ethics.
- Williams, J, Elson, R.J (2010) "Improving Ethical Education in The Accounting Program: A Conceptual Course". Academy of Educational Leadership Journal, Volume 14, Number 4, 107-114.
- Zengin.K, Y, Erdener, E, Var, Turgut (2009) "Ethical behavior in Accounting: Some Evidence from Turkey" African Journal of Business Management. Vol 3, 540-547.

SKK DHE ROLI I TYRE NË TRANSFORMIMET E FINANCAVE TË BIZNESEVE

KLODIAN BLLACI

Dokt. UET, E-mail: bllaciklodiana@gmail.com

PROF. DR. MAGDALENA BREGASI

UET, E-mail: magdalena.bregasi@uet.edu.al

ABSTRAKT

Financat e biznese shqiptare pësuan transformime të dukshme dhe të rëndësishme në 25 vite tranzicion. Transformimet u kushtëzuan fillimisht nga ndryshimet e pronësisë dhe shndërrimit të ish-ndërmarrjeve të centralizuara në shoqëri tregtare. Ata u paraprinë nga ligji i parë kontabël i vitit 1993 dhe në vijim nga procesi i formimit dhe konsolidimit të standardeve kombëtare të kontabilitetit (S.K.K.) të ndjekura me përshtatjen e standardeve ndërkombëtare kontabilitetit (S.N.K.). Aktualisht, transformimet e regjistrimeve kontabël dhe të sistemeve të informacionit të shoqëruara me mbështetje legale, teknologjike (programe kompjuterike) dhe institucionale kanë konsoliduar raportimet financiare të bizneseve të vendit tonë. Bazuar në këtë hipoteze, ku punim synon t'i përgjigjet pyetjeve kërkimore: A janë përmirësimet e SKK një reflektim ndaj ndryshimeve të kërkuara nga praktikantët kontabile të profesionistëve hartues të pasqyrave financiare, ekspertëve kontabël? A janë këto ndryshime të bëra një përshtatje e ndryshimeve ndaj SNK si kërkesë e harmonizimit? Ndryshimet e bëra në disa nga SKK a kanë rritur shkallën e realizimit dhe përshtatshmërisë të pasqyrave financiare për përdoruesit e jashtëm? Cilat janë vështirësitë të cilat priten të hasen nga zbatimi i SKK të përmirësuar nga profesionistët ?

Punimi do të fokusohet në analizën e specifikave të S.K.K. të përmirësuar të cilat u bënë të detyrueshme për bizneset shqiptare nga 1 janari 2015. Për këtë ne do të ndalemi në evidentimin e disa problemeve me të cilat kontabilistët dhe financierët e bizneseve kanë hasur në praktikë me vendosjen e S.K.K. dhe me cilat probleme ata mund të ballafaqohen potencialisht gjatë procesit të zbatimit të S.K.K. të përmirësuar.

Fjalë kyç: *Standardet kombëtare të kontabilitetit, standardet kombëtare të përmirësuar, detyrimet tatimore, amortizimi dhe provigjionet aktivet afatgjata të investuara.*

1. Hyrje

Financat e biznese shqiptare pësuan transformime të dukshme dhe të rëndësishme në 25 vite tranzicion. Sistemi shqiptar i kontabilitetit daton që në vitin 1947, si një kopje e ish-Bashkimit Sovjetik dhe pak ndikim nga shkolla italiane.

Situata e trashëguar në fillim të viteve nëntëdhjetë, kur vendi po hynte në kushtet sistemit të ekonomisë së tregut, nxori në pah nevojën e shpejtë: (1) për të paraqitur dhe zbatuar një sistem kontabiliteti të ri që duhet të ishte në të njëjtën linjë me tendencat e fundit të kësaj fushe dhe (2) për të krijuar specialist të aftë që të jepnin shërbimin e tyre me nivel të lartë profesionalizmi dhe integriteti (Çela, 2007).

Ndryshimet e pronësisë dhe shndërrimit të ish-ndërmarrjeve të centralizuara në shoqëri tregtare në kuadrin e reformimit të vendit sipas reformave të ekonomisë së tregut dhe ristrukturimit e ndërmarrjeve u paraprinë nga ndryshimet e para në fushën e kontabilitetit. Nga Ligji i parë kontabël i vitit 1993 që zëvendësoi ligjin e mëparshëm që udhëhiqte veprimtarinë e ish-ndërmarrjeve shtetërore, viti 2004 shënoi pasurimin e bazës legale kontabile me ligjin e ri të kontabilitetit dhe pasqyrat financiare duke vënë theksin në përcaktimin e standardeve kontabël. Në vijim dallohet procesi i formimit dhe konsolidimit të standardeve kombëtare të kontabiliteti (S.K.K.) të ndjekura me përshtatjen e standardeve ndërkombëtare kontabilitetit (S.N.K.) dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre nga 1 Janar i vitit 2008.

Tashmë mund të themi që kemi bazë ligjore të përshtatshme dhe standarde kontabiliteti të realizueshme dhe të përshtatshme për raportimin financiar. Gjithashtu, ka organizma institucionale dhe profesionale që luajnë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e këtyre standardeve (Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, shoqatat e kontabilistëve, etj.)

Kontabiliteti po kalon një periudhë ndryshimi të madh edhe në rrafshin global, ku sfida më madhore e profesionit të kontabilitetit në mbarë botën është përshtatja dhe ecja në të njëjtin rritëm me këtë ndryshim (Ritche, 2010). Për pasojë, sfida kryesore mbetet zhvillimi i vazhdueshëm profesional i profesionistëve kontabël, trajnimi i vazhdueshëm i tyre, por nga ana tjetër, edhe krijimi i një kanali komunikimi dypalësh ndërmjet tyre dhe organizatave apo autoriteteve rregullatore kontabël, pra funksionimin e vërtetë të tryezave të rrumbullakëta. Një tjetër sfidë është edhe edukimi i përdoruesve të pasqyrave financiare, në mënyrë që ato të kuptohen dhe të jenë të dobishme për ta. Kjo është një tjetër sfidë për profesionin e kontabilitetit dhe shkollat e specializimit në këtë drejtim. Një ndër përdoruesit kryesorë të raportimeve financiare janë organet tatimore. Ajo çfarë vihet re nga praktikantët e hartuesve dhe audituesëve të pasqyrave edhe pse sipas legjislacionit tatimor, Formulari i Deklarimit dhe Pagesës së Tatimit mbi Fitimin duhet të shoqërohet nga kopja e Pasqyrave Financiare, ndërmarrjet përsëri priren të zbatojnë rregullimet tatimore duke zbehur orientimet e standardeve kontabël.

Në kushtet e një ekonomie globale, njësitë e ekonomike të një vendi, pra edhe të Shqipërisë ballafaqohen me një presion në rritje të konkurrencës, si nga operatorët e tregjeve të vendit ashtu edhe nga operatorët e tregjeve ndërkombëtare. Për të mundur rritjen e qëndrueshme të njësisë ekonomike në një treg konkurrues është shumë jetike zotërimi i një informacioni të plotë dhe të saktë financiar, informacioni i cili kryesisht sigurohet nga sistemet kontabël të informacionit (Lati, 2012).

Harmonizimi i standardeve të kontabilitetit, si një kërkesë emergjente në përshtatje me zhvillimet ekonomike botërore, krijon mundësi shumë të mira që nëpërmjet uniformitetit të raportimit financiar, nëpërmjet krahasueshmërisë dhe konsistencës të bëjë të mundur që të tërheqë më shumë investitorë të huaj në Shqipëri.

2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij punimi është të evidentojë situatën në të cilën do të zbatohen Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara si një evidencë e qartë e evolucionit dhe zhvillimit profesional të këtyre standardeve. Këto standarde janë bërë të detyrueshme për t'u zbatuar që nga data 1 Janar 2015, sipas Udhërit të Ministrit të Financave nr. 64, datë 22.07.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”. Ndryshimet e bëra në disa nga SKK sa kanë rritur shkallën e realizimit dhe përshtatshmërisë të pasqyrave financiare për përdoruesit e jashtëm.

Fillimisht do të ndalemi në arsyet pse ky përmirësim u bë i domosdoshëm, nëse ishin kërkesa të praktikave të hasura nga profesionistët apo një reflektim dhe harmonizim me SNK të kërkuara për t'u bërë De Juro nga Komuniteti Europian, si një hap i domosdoshëm në rrugën e integritetit të Shqipërisë në BE.

Në punim bëhet një analizë e shkurtër për të evidentuar se cilat janë njësitë ekonomike që përdorin SKK duke synuar nxjerrjen në pah të rëndësisë së SKK dhe nevojës së përmirësimit të tyre. Ai analizon gjithashtu ndryshimet e bëra sipas secilës SKK. Më pas punimi ndalet në evidentimin dhe analizën e disa problemeve, të cilat kontabilistët dhe financierët e bizneseve i hasen në praktikë me vendosjen e S.K.K. dhe me cilat ata mund të ballafaqohen potencialisht gjatë procesit të zbatimit të S.K.K. të përmirësuara.

Në mënyrë më specifike përqendrohemi në SKK 2 të përmirësuara “Paraqitja e pasqyrave financiare”, SKK 5 të përmirësuara “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale”, SKK 6 të përmirësuara “Provizionet, aktivet dhe pasivet e kushtëzuara”, SKK 11 të përmirësuara “Tatimi mbi fitimin”.

Një element tjetër i analizës është edhe analiza e përgjithshme e raportimit financiar për qëllime tatimore si dhe disa nga dallimet mes disa nga elementët e veçantë të pasqyrave financiare. Gjithashtu vëmendja jonë ndalet edhe në ballafaqimin me qëndrimet e profesionistëve në botë në lidhje me përdorimin e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar, SNRF-ve, si bazë tatimore reflektuese e efekteve do të kishte në financat e biznesit dhe në ekonominë e vendit.

Në këtë punim nuk paraqiten përshkrimet teknike të rregullave të kontabilitetit, të standardeve, të praktikave kontabël apo tatimore.

3. Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Financat e biznese shqiptare pësuan transformime të dukshme dhe të rëndësishme në 25 vite tranzicion. Ndryshimet e financave të bizneseve janë të natyrës juridike dhe kontabël. Nga ligji i parë kontabël i vitit 1993, vitet e fundit i përkasin zbatimit dhe konsolidimit të Standardeve Kontabël të Kontabilitetit (SKK) dhe së fundi dhe në përmirësimin e SKK-ve. Efektet e transformimeve kontabël në nivel kombëtar, duke u ndalur në specifikat e SKK të përmirësuara janë fokusi i punimit. Transformimet e regjistrimeve kontabël dhe të sistemeve të informacionit të shoqëruara me mbështetje legale, teknologjike (programe kompjuterike) dhe institucionale kanë efekte pozitive dhe kanë konsoliduar raportimet financiare të bizneseve të vendit tonë. Pyetjet kërkimore, që ngrihen në lidhje me hipotezën e mësipërme janë:

- A janë përmirësimet e SKK-ve një reflektim ndaj ndryshimeve të kërkuara nga praktikantët kontabile të profesionistëve hartues të pasqyrave financiare, ekspertëve kontabël?
- A janë këto ndryshime të bëra një përshtatje e ndryshimeve ndaj SNK si kërkesë e harmonizimit në nivel global? Ndryshimet e bëra në disa nga SKK a kanë rritur shkallën e realizimit dhe përshtatshmërisë të pasqyrave financiare për përdoruesit e jashtëm?
- Cilat janë vështirësitë të cilat priten të hasen nga zbatimi i SKK të përmirësuar nga profesionistët?

Analiza e problemit ka karakter teorik dhe empirik. Në aspektin metodologjik duhet të nënvizojmë se:

Së pari, punimi ynë merr në konsideratë analizën e studimeve dhe punimeve të autorëve të huaj dhe vendas që lidhen me fokusin e tij. Së dyti, evidentohen problemet me të cilat kontabilistët dhe financierët e bizneseve kanë hasur në praktikë me vendosjen e S.K.K.

Së treti, jepen gjykime paraprake nëse SKK e përmirësuara do të lehtësojnë praktikantët apo thjesht do të rregullojnë kornizat e sistemit kontabël. Në fakt, më specifikisht, ne përqendrohemi në SKK 2 i përmirësuar “Paraqitja e pasqyrave financiare”, SKK 5 i përmirësuar “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale”, SKK 6 i përmirësuar “Provizionet, aktivet dhe pasivet e kushtëzuara”, SKK 11 i përmirësuar “Tatimi mbi fitimin”.

Së katërti, jepen gjykime për influencën e rregullave tatimore në vendimmarrjen e raportimit financiar sipas standardeve të përmirësuara.

Të dhënat grumbulluara nga pyetësorët drejtuar profesionistëve për zbatimin dhe evidentimin e problematikave të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-ve) përbëjnë bazën e të dhënave. Pyetësori është ndërtuar në dy pjesë. Pjesa A- Pyetësori për profesionistët, lidhet me përgatitjen e tyre profesionale, trajnimeve të cilat ata ndjekin, lidhjen e tyre me organizatat profesionale dhe me angazhimin e mundshëm që ata kanë patur në procesin e hartimit të SKK-ve të përmirësuara. Pjesa B - Zbatimi i standardeve të kontabilitetit, lidhet më praktikisht me njohjen dhe zbatimin e SKK-ve, si dhe me ndikimet që legjislacioni tatimor ka mbi elementët e pasqyrave financiare. Pyetësorët u shpërndanë nëpërmjet postës elektronike (e-mail-ve) dhe takimit të drejtpërdrejtë gjatë periudhës mars - maj 2015. Gjithsej u shpërndanë 30 pyetësorë nga të cilët u mbledhën të dhëna nga 21 profesionistë. Numri i pyetësorëve të realizuar mbetet një kufizim i trajtimit të problematikës dhe pritet të përmirësohet në një stad të dytë të thellimit të punimit të paraqitur në konferencë. Kjo justifikohet me argumentin se vështirësia kryesore në plotësimin e pyetësorëve nga profesionistët ishte fakti që zbatimi i SKK-ve të përmirësuara akoma nuk është finalizuar në hartimin e pasqyrave financiare, pasi ato filluan më 1 Janar 2015. Gjithashtu, një tjetër element për t'u përmendur, është fakti që përgjigjet e pyetjes 5, pjesa A, në lidhje me shpeshësinë e marrjes së përgjigjes për problemet e hasura në praktika, profesionistët iu përgjigjën me ngurrim pasi mendonin që kjo do të ndikonte në marrëdhënien e tyre me shoqatën ku ata bënin pjesë.

4. Analizë, interpretim të dhënash

Situata e trashëguar në fillim të viteve nëntëdhjetë, kur vendi po hynte në sistemin e ri, sistemit të ekonomisë së tregut, theksoi nevojën e menjëhershme për: (1) futjen e dhe zbatimin e një sistemi të ri të kontabilitetit që duhet të jetë në përputhje me tendencat e fundit në këtë fushë; dhe (2) duke krijuar profesione të pavarur të kontabilitetit të aftë për të dhënë shërbimet e tyre me nivel të lartë të profesionalizmit dhe integritetit.

Në Shqipëri nuk ka pasur ndonjë bazë për të hartuar ose për të sjellë risi në sistemin tonë si origjinale. E vetmja mënyrë në mjedisin tonë post-komunist ishte përzgjedhja, përshtatja dhe zbatimi i një modeli që do të ishte në përputhje me Direktivat e BE-së dhe praktikantët e saj. Duke pasur në konsideratë qëllimet tona lidhur me integritetin e vendit në BE si dhe traditat ligjore dhe profesionale të mëparshme, çdo model i përzgjedhur duhet të jetë ai që do të mund të zbatohet lehtësisht në praktikë. (Çela, 2007). Fillimisht u hartua Plani i Përgjithshëm Kontabël në nivel kombëtar, i cili ishte i ngjashëm me sistemin kontabël francez për arsyet: a) tradita e këtij sistemi me baza karteziante rregullimi dhe ngjashmëria e këtij sistemi me rregulla si ato të përdorura në ekonomitë e komanduara; b) nevoja për një aplikim më të gjerë si në sektorin publik ashtu dhe në atë privat; c)

mungesa e eksperiencës së profesionistëve të asaj kohe me standardet ndërkombëtare; d) lidhja midis praktikave kontabël dhe fiskale; e) kërkesa të tjera që vinin nga rregulla dhe ligje të tjera të rëndësishme.

Një element tjetër shumë i rëndësishëm në zhvillimin e standardeve kontabël janë edhe organizmat profesionalë të cilët sigurojnë zhvillim të vazhdueshëm të profesionit në përputhje me kërkesat e ekonomisë së vendit dhe standardeve ndërkombëtare. Shoqatat e kontabilistëve, Instituti i Eksperteve Kontabël të Autorizuar, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit si dhe autoritet shtetërore përbëjnë organizmat profesionale të zhvilluar deri më sot në vendin tonë.

Ian Ritchie, Drejtues i Ekipit të projektit të financiar nga Banka Botërore për përforcimin e kapaciteteve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit në Shqipëri do të thoshte në Konferencën Jubilarë në 2012 se: *“Projekti ynë përfshin dy elemente bazë, të cilat ndoshta e përmbledhin të gjithë gamën e sfidave me të cilat përballlet profesioni i kontabilitetit në Shqipëri. Elementi i parë i projektit tonë është ofrimi i asistencës teknike për të përfortuar procesin e hartimit të standardeve përmes përmirësimit të transparencës dhe pjesëmarrjes më të gjerë të palëve të interesuara. Ndërsa elementi i dytë është krijimi i një mekanizmi të qëndrueshëm për adoptimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe përditësimin e përkthimit të tyre, si pjesë e procesit të pranimit të SNRF-ve për përdorim në Shqipëri... kontabiliteti global po kalon një periudhë ndryshimi të madh, ku sfida më madhore e profesionit të kontabilitetit në mbarë botën është përshtatja dhe ecja në të njëjtin rritëm me këtë ndryshim”*.

Katër nevojat vijuese kryesore janë pasojë e diktuar nga mjedisi dinamik i profesionit kontabël:

Së pari, është e nevojshme përshtatja me ndryshimet e SNRF-ve. Kjo kërkon investim gjithnjë e në rritje në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të profesionistëve të kontabilitetit në Shqipëri. Kontabilistët shqiptarë duhet të jenë plotësisht në njohur me ndryshimet, në mënyrë që t'i zbatojnë ato në raportimin korporativ në të gjithë vendin.

Së dyti, është i nevojshëm përmirësimi i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit në mënyrë që raportimi financiar për ndërmarrjet shqiptare të vogla dhe të mesme t'i afrohet standardit ndërkombëtar. Barra për përmirësimin e standardeve bie mbi Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, por barra për zbatimin e tyre bie mbi të gjithë profesionin e kontabilitetit.

Së treti, është e nevojshme që të mendohet mbi kontabilistët e së ardhmes. Mjedisi i raportimit financiar ka ndryshuar dhe do të vazhdojë të ndryshojë dhe trajnimi dhe kualifikimi profesional duhet të fokusohen në aftësitë që kontabilistët dhe audituesit duhet të kenë për t'u përshtatur një mjedisi në ndryshim të vazhdueshëm.

Së fundi, është i nevojshëm edukimi i përdoruesve të pasqyrave financiare. Qëllimi kryesor i pasqyrave financiare është të “japin informacion financiar që është i dobishëm në marrjen e vendimeve.” Nëse përdoruesit nuk i kuptojnë pasqyrat financiare, atëherë pasqyrat financiare, sipas përkufizimit më lart, nuk mund të jenë të dobishme. Kjo është ndoshta sfida më e madhe për profesionin e kontabilitetit. (Ritchie, 2012)

Ndër zhvillimet më të fundit të raportimit financiar është dhe nxjerrja e Direktivës së Bashkimit Europian për Kontabilitetin në vitin 2013/34/EU¹.

Direktiva e Kontabilitetit e vitit 2013, përcakton kuadrin ligjor për pasqyrat financiare individuale dhe ato të konsoliduara të entiteteve të biznesit në BE. Kjo direktivë duhet të transpozohet në legjislacionin kombëtar të vendeve anëtare të BE, duke filluar nga data 20 korrik 2015, dispozitat do të zbatohen për pasqyrat financiare (PF) 2016 e në vazhdim.

Me një prioritet të veçantë kjo direktivë vendosi para KKK detyrën për të përafuar kuadrin kontabël shqiptar me atë të BE. Raportimi financiar sipas SNK u vendos në Shqipëri në 2008, ndërsa SKK janë ndërtuar si një variant i thjeshtësuar i SNRF të 2012, ndërkohë SNK kanë bërë shumë ndryshime gjatë këtyre viteve.

Harmonizimi i standardeve të kontabilitetit, si një kërkesë emergjente në përshtatje me zhvillimet ekonomike botërore, krijon mundësi shumë të mira që nëpërmjet uniformitetit të raportimit financiar, nëpërmjet krahasueshmërisë dhe konsistencës të bëjë të mundur që të tërheqë më shumë investitorë të huaj në Shqipëri.

Pas një pune intensive gati një vjeçare KKK nxori për diskutim më 15 shtator 2013, një variant të përmirësuar të SKK-ve. Afati i pritjes së diskutimeve dhe komenteve në lidhje me përmirësimet ishte 15 Mars 2014 dhe u shty për 15 qershor 2014. Komente nuk ka patur formalisht. Diskutimet janë bërë me anë të 4 tavolinave të rrumbullakëta. U ngritën grupe pune me përfaqësues të organizatave profesionale. Diskutimet u bënë vetëm mbi formatin dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare. Në verën e vitit 2014 doli Urdhri i ministrit Nr. 64, datë 22.07.2014 “Për shpalljen e standardeve të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”. Zbatimin e standardeve është bërë i detyrueshëm duke u nisur nga data 1 Janar 2015.

SKK e përmirësuara paraqiten në dy pjesë. Pjesa A përfshin paragrafët të cilët janë të detyrueshëm për zbatim. Pjesa B e standardeve nuk është e detyrueshme për zbatim, por përbën baza për konkluzionet e përmirësimeve dhe udhëzues për zbatimin e standardeve. Shkurtimisht më poshtë po listojmë ndryshimet kryesore për secilin nga Standardet.

SKK 1 të përmirësuara “Kuadri i Përgjithshëm për përgatitjen e Pasqyrave Financiare”: Prezantohen të ardhurat gjithëpërfshirëse; shtohet një kërkesë për shënime shpjeguese; ndryshon terminologjia;

SKK 2 të përmirësuara «Paraqitja e pasqyrave financiare»: ndryshon emërtimi i PF; ndryshon terminologjia, p.sh, në vend të termit «pasiv» përdoret «detyrim»; sqarohet koncepti i vijimësisë; më shumë detaje në lidhje me konceptin e materialitetit; shtohet koncepti i monedhës funksionale; udhëzime mbi paraqitjen e dividendëve dhe interesin e paguar në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare.

SKK 3 të përmirësuara “Instrumentet financiare”: ngushtohet fusha vetëm në instrumentet e thjeshta financiare; sqarohet më shumë koncepti i matjes fillestare; ndalohet zbatimin e modelit të vlerës së drejtë.

SKK 4 të përmirësuara “Inventarët”: nuk përdoret më termi ‘vlera neto e realizueshme’; shtohet trajtimi kontabël i blerjeve të inventarëve në kushtet e pagesave të shtyra në afate.

Directive 2013/34/EU of the European Parliament and the Council of 26 June 2013 on the annual financial statements, consolidated financial statements and related reports of certain types of undertakings, amending Directive 2006/43/EC of the European Parliament and of the Council and repealing Council directives 78/660/EEC and 83/349/EEC.

SKK 5 të përmirësuara « Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale »: trajtohen aktivet materiale të investuara; shtohet përkufizimi i kostove të huamarrjes dhe shpenzimet e interesit njihen si shpenzime periudhe; emri i mirë amortizohet për 10 vjet; shtohen udhëzimet lidhur me njohjen jetën e dobishme të një aktivi, llogaritjen e amortizimit.

SKK 6 të përmirësuara “Provizionet, aktivet dhe pasivet e kushtëzuara”: detajohet matja e provizioneve; hiqen trajtimi i provizioneve për pensionet; kërkohen më shumë shënime shpjeguese lidhur me provizionet, aktivet dhe pasivet e kushtëzuara.

SKK 7 të përmirësuara “Kontabilizimi i qirave”: saktësohen përjashtimet nga fusha e zbatimit të standardit.

SKK 8 të përmirësuara “Të ardhurat”: shtohen udhëzimet për matjen e arkëtimeve të shtyra në kohë; shtohet rasti i trajtimit të formave të reja të të bërit biznes p.sh rasti i kartave të besnikërisë së klientëve; udhëzime më të thjeshta dhe më të detajuara për metodën e fazës së përfundimit, shitjen e mallrave, kontratave të ndërtimit.

SKK 9 të përmirësuara “Kombinimet e bizneseve” ka më së shumti ndryshime që janë formulime gjuhësore.

SKK 10 të përmirësuara “Granitet dhe format e tjera të ndihmës”: nuk ka më ndarje të graniteve sipas natyrës; kusht për njohjen e granitit është plotësimi i performancës.

SKK 11 të përmirësuara “Tatimi mbi fitimin”: shtohen paragrafët që trajtimin e tatimit mbi fitimin aktual dhe tatim fitimi i shtyrë; hiqen udhëzimet për aktivet dhe detyrimet tatimore për kombinimin e bizneseve që mbahen me vlerën e drejtë.

SKK 12 të përmirësuara “Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimeve”: shtohen udhëzime mbi konceptin e monedhës funksionale dhe kur kjo e fundit është e ndryshme me monedhën raportuese; shtohen udhëzime për investimet në entitete të huaja.

SKK 13 të përmirësuara “Aktivet biologjike”: shtohet trajtimi i marrëveshjeve koncesionare; lejohet modeli i koston shtesë.

SKK 14 të përmirësuara “Trajtimi kontabël i shoqërive të kontrolluara dhe pjesëmarrjeve”: shtohen kërkesat lidhur me përcaktimin e kombinimit të biznesit dhe të konsolidimit të pasqyrave financiare; thjeshtësohen analizat e blerësit të biznesit për çmimin e blerjes: shtohen kërkesat për regjistrimin e detyrimeve të kushtëzuara në një kombinim biznesi; nuk kërkohet më testi i zhvlerësimit të emrit të mirë; janë shtuar kërkesat për rastet kur një shoqëri mëmë është e lejuar të mos hartojë pasqyrat e konsoliduara, etj.

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm në zhvillimin dhe evoluimin e standardeve kontabël dhe zbatimin e tyre është legjislacioni tatimor. Tatimpaguesi paraqet në organet tatimore Formularin e Deklarimit dhe Pagesës së Tatimit mbi Fitimin, së bashku me pasqyrat analitike, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, së bashku me kopjen e pasqyrave financiare të njëjësive ekonomike të cilat justifikojnë llogaritjen e bërë për tatim e fitimin e pagueshëm². Më poshtë paraqiten dallimet midis raportimit financiar dhe tatimor sipas studimeve të bëra në 2013:

TABELA NR. 1: DISA DALLIME MIDIS RAPORTIMIT FINANCIAR DHE RAPORTIMIT TATIMOR”

Përshkrimi	Raportimi sipas SKK	Raportimi sipas legjislacionit tatimor
Inventarë	Ka përkufizime të qarta për kuptimin e inventarëve. Vlerësimi pas njohjes fillestare është me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Lejon kryerjen e testeve për zhvlerësim.	Nuk ka përkufizime apo procedura për kuptimin e inventarëve. Zhvlerësimi dhe rivlerësimi, nuk njihen për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm.
Aktive Afatgjata Materiale	Ka përkufizime të qarta për njohjen e AAM. Ka kritere të qarta mbi vlerësimin e AAM, si dhe të elementeve që do të përfshihen në kosto. Ka të mirëpërcaktuara normat e amortizimit. Lejon kryerjen e testeve për rivlerësimet e AAM	Nuk ka përkufizime apo procedura për njohjen e AAM. Njohja e AAM bëhet mbi bazën e faturës tatimore. Ka norma dhe metoda të amortizimit të ndryshme nga SKK dhe çdo tejkallim është shpenzim i panjohur. Nuk i njeh shpenzimet e zhvlerësimit të AAM.
Aktive Afatgjata Jomaterial	Ka përkufizime të qarta për njohjen e AAJM. Ka kritere të qarta mbi vlerësimin e AAJM, si dhe të shpenzimeve që do të përfshihen në kosto apo si shpenzime të periudhës ushtrimore. Ka të mirëpërcaktuara normat e amortizimit.	Nuk ka përkufizime të qarta për njohjen e AAJM. Shpenzimet e nisjes nuk i njeh si shpenzime të periudhës ushtrimore. Ka të mirëpërcaktuara normat e amortizimit dhe çdo tejkallim nuk është shpenzim i njohur.
Instrumentat financiare	Ka përkufizime të qarta për njohjen e IF dhe për vlerësimin e tyre.	Mban qëndrim të ngurtë për sa i përket trajtimit të instrumentave financiare dhe kryesisht kërkesave për t'u arkëtuar.
Zhvlerësimi	Ka përkufizim të qartë mbi zhvlerësimin. Humbja nga zhvlerësimi/ apo rimarrja e saj njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të periudhës.	Nuk e trajton këtë çështje dhe humbja nga zhvlerësimi nuk njihet si shpenzim i periudhës.

2 Ligj Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar.

Provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara	Ka përcaktime të qarta mbi njohjen e një provizionit, aktivi dhe pasivi të kushtëzuar. Shuma e shpenzimeve për provizione njihen si shpenzime të periudhës. Po ashtu edhe rimarrja e tyre njihet në PASH.	Nuk i njeh shpenzimet e provizioneve (bëjnë përjashtim bankat dhe kompanitë e sigurimeve). Rimarrja e një provizionit nga njësia ekonomike, njihen dhe i shtohen fitimit për llogaritjen e tatim mbi fitimin.
Tatimi i shtyrë	Ka përcaktime të qarta mbi kriteret e njohjes së tatimit të shtyrë.	Nuk gjenden parashikime në lidhje me tatimin e shtyrë.
Të ardhurat	Ka përcaktime të qarta mbi kriteret e njohjes së të ardhurave në PASH.	I njeh të ardhurat në momentin furnizimit, i cili quhet i kryer në momentin kur është e detyrueshme të lëshohet fatura.
Shpenzimet	Ka përcaktime të qarta mbi kriteret e njohjes së të ardhurave në PASH.	Ka shpenzime të cilat janë të panjohura (si shpenzimet për përfaqësim dhe shpenzimet për pritje-përcjellje të cilat tejkalojnë shumën 0.3% të qarkullimit vjetor; shpenzime interesi përtej normave mesatare të shpallura nga banka e Shqipërisë; etj.)

Burimi: Ujkani M., (2013): Zbatimi i standardeve të kontabilitetit, raportimi financiar dhe tatimor në Shqipëri.

Sipas një studimi të bërë mbi pasqyrat e pakonsoliduara të filialeve multinacionale në Europë, rezultatet ofrojnë dëshminë e një lidhjeje të re të rëndësishme në mes të kontabilitetit financiar dhe tatimit planifikuar, duke sugjeruar se një standardi të unifikuar të kontabilitetit nëpër juridiksione në nivel filiali rrit fleksibilitetin e entiteteve multinacionale për të zhvendosur të ardhurat.

Sipas një studimi të bërë në Republikën Çeke arrihet në konkluzionin se zbatimi i SNRF edhe për llogaritjet e të ardhurave të taksueshme, shtetet humbasin fuqinë për të kontrolluar në mënyrë efektive mbledhjen e taksave në mënyrë që të plotësojnë nevojat e tyre fiskale. SNRF janë publikuar për qëllime të tregjeve të kapitalit dhe investitorëve në vendimmarrje e tyre, ata nuk do të adresojnë çështjet e taksave. Një ndryshim i vetëm në çfarëdo standardi mund të çojë në një ndryshim ekstrem në fitimet e kontabilitetit dhe kështu në mbledhjen e taksave. Ky është një rrezik i rëndë, i cili lind në lidhje me lejimin e SNRF si një bazë e taksave. Një analizë paraprake e kryer se “kompanitë SNRF” gjenerojnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të tatimit mbi të ardhurat, me mundësi rritje të fortë të aksioneve, nëse opsioni i SNRF është shfrytëzuar nga kompani të drejta e jo të listuara të përcaktuara nga ligji çek në kontabilitet.

Sipas të dhënave të publikuara për Shqipërinë 2013 nga Doing Business, World Bank Enterprise Surveys, për seksionin Rregullat dhe Taksat, vihet re se koha e harxhuar nga menaxhimi i nivelit të lartë për të qenë në përputhje me kërkesat rregullore është 6,7 % ndërkohë që krahasimi me rajonin e Evropës Perëndimore dhe Azisë Qendrore është 12,1% dhe të gjitha vendet e përfshira në këtë anketim 9.8%. Pra, në lidhje me këtë indikator, Shqipëria renditet mirë krahasuar me rajonin. Indikatorët në lidhje me numrin e vizitave dhe takimeve të nevojshme me zyrat e taksave është 3 herë më shumë sesa rajoni dhe Europës Perëndimore dhe Azisë Qendrore që tregon influencën e fortë që ka legjislacioni tatimor dhe zbatimi i tij duke mbivendosur aplikimet e standardeve kontabile, atje ku është e lejuar.


TABELA NR. 2: TË DHËNAVE TË PUBLIKUARA PËR SHQIPËRINË 2013 NGA DOING BUSINESS, WORLD BANK ENTERPRISE SURVEYS

Indikatorët	Shqipëria		
	Rajoni i Evropës Perëndimore dhe Azisë Qendrore	Të gjitha vendet	
Menaxhimi i nivelit të lartë për të qenë në përputhje me kërkesat rregullore (%)	6.7	12.1	9.8
Numri i vizitave dhe takimeve të nevojshme me zyrat e taksave	5.0	1.6	1.7
Nëse ka vizita apo takime numri mesatar i tyre	5.5	2.5	2.8
Përqindja e firmave që e shohin normat e taksave si vështirësi kryesore	12.8	24.1	31.0

Burimi: Enterprise Surveys (<http://www.enterprisesurveys.org>), The World Bank, 2013

Ndërkohë mund të themi që treguesit e tjerë tregojnë një ambient të pëlqyeshëm dhe të pranueshëm nga investitorë vendas apo të huaj në aspektin e legjislacionit tatimor dhe rregullator. Pyetësi për mbledhjen e të dhënave është i drejtuar profesionisteve sipas profesionit, nga të cilët 33% janë ekspertë të regjistruar kontabël, 29% janë kontabël të miratuar dhe 38% janë kontabilist të punësuar në një firmë zbatuese të SKK-ve.


FIGURA NR. 1: SHPËRNDARJA SIPAS PROFESIONI I TË ANKETUARVE



Burimi: Pyetësor për profesionistët, Bllaci 2015

Pjesa A-Pyetësor për profesionistët lidhet me përgatitjen e tyre profesionale, trajnimeve të cilat ata ndjekin, lidhjen e tyre me organizatat profesionale dhe me angazhimin e mundshëm që ata kanë patur në procesin e hartimit të SKK-ve të përmirësuara.


FIGURA NR. 2: FREKUENCA E TRAJNIMEVE NË LIDHJE ME NJOHJEN E STANDARDEVE



Burimi: Pyetësor për profesionistët, Bllaci 2015


Vihet re që trajnimet në lidhje me zbatimin e standardeve bëhet në 48% të rasteve vetëm kur ka ndryshime të standardeve Fig.2 gjithashtu, rastet më të shumta të kontaktimit të me shoqatën behet në rastet ku ka ndryshime të standardeve 48% e rasteve, Fig.3. Nga analiza e pyetësorëve të gjithë të anketuarit e njihnin Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit. Ata e kontaktonin KKK-në në 76% të rasteve kur ka ndryshime të standardeve dhe në 58% të rasteve kanë marrë përgjigje.

FIGURA NR. 4: KONTAKTIMI I KKK



Burimi: Pyetësor për profesionistët, Bllaci 2015

FIGURA NR. 5: FREKUENCA E KONTAKTEVE ME SHOQATËN KU BËJNË PJESË TË ANKETUARIT



Burimi: Pyetësor për profesionistët, Bllaci 2015

Në lidhje me procesin e hartimit të SKK të përmirësuara është bërë një punë mjaft e mirë nga KKK por një pjesëmarrje më e gjerë është dashur nga profesionistët, 90% e rasteve do të dëshironin të kishin marrë pjesë. Vetëm një nga të anketuarit kishte marrë pjesë në tryezat e rrumbullakëta. Kjo duket edhe nga përgjigjet e të anketuarve Fig. 6 dhe Fig. 7. Një pjesëmarrje më e gjerë do të kishte sjellë më shumë reflektime nga problemet e hasura nga praktikant.

FIGURA NR. 6: TRYEZAT E RRUMBULLAKËTA



Burimi: Pyetësor për profesionistët, Bllaci 2015

FIGURA NR. 7: DËSHIRA E PJESËMARRJES



Burimi: Pyetësor për profesionistët, Bllaci 2015

FIGURA NR.8: PËRGJIGJET E PYETJES 14-PJESA A



Burimi: Pyetësor për profesionistët, Bllaci 2015

Në lidhje me arsyet e hartimit të SKK-ve të përmirësuara 90% e të anketuarve mendojnë që arsyeja e përmirësimit vjen si reflektim ndaj ndryshimeve të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të kërkuar si element i rëndësishëm në aderimin në Bashkimin Europian. Ndërsa 52% e të anketuarve mendojnë që përmirësimi i SKK-ve erdhi si rezultat i kërkesave të praktikave kontabël dhe financiare të bizneseve që zbatojnë SKK-të.

FIGURA NR. 9: PËRGJIGJET E PYETJES 15-PJESA A



Burimi: Pyetësor për profesionistët, Billaci 2015

Pjesa B e pyetësorit fokusohet në dhënien përgjigje të dy pyetjeve, atë të faktit që përmirësimet janë kërkuar si rezultat i praktikave dhe fakti i dytë është që vështirësitë që lidhen me legjislacionin tatimor kundrejt aplikimit të standardit kontabël nuk kanë ndryshuar edhe pas përmirësimit të SKK-ve.

TABELA NR. 3: TË DHËNAT E GRUMBULLUAR NË PJESËN B TË PYETËSORIT

5. A mendoni se paketa e plotë e SKK-ve e përmirësuar (e përbërë gjithsej nga 15 standarde) është e përshtatshme për të dhënë një pamje të vërtetë dhe të sigurtë të aktivitetit tuaj?	PO	JO	N/A	
Përgjigjet	48%	10%	19%	
6. Për raportimin financiar për qëllime tatimore, a mendoni se paketa e plotë e pasqyrave financiare e ndërtuar në lidhje me SKK e përmirësuar është e realizueshme dhe e përshtatshme?	PO	JO	N/A	
Përgjigjet	57%	0%	14%	
A keni dëgjuar se pasqyrat tuaja financiare duhet të plotësohen mbi bazën e standardeve të kontabilitetit të përmirësuar nga 1 Janar 2015?	POJON/A			
Përgjigjet	62%	5%	10%	
8. Sa të vështirë e shihni zbatimin e SKK 2 të përmirësuar "Paraqitja e pasqyrave financiare"?	SHUMË	PAK	ASPAK	N/A
Përgjigjet	0%	33%	38%	10%
9. Sa të vështirë e shihni zbatimin e konceptit të të ardhurave gjithëpërfshirëse të SKK 2 të përmirësuar "Paraqitja e pasqyrave financiare"?	SHUMË	PAK	ASPAK	N/A
Përgjigjet	0%	48%	29%	10%
10. Në SKK 2 të përmirësuar është shtuar koncepti i trajtimit të monedhës funksionale. Sa herë e keni hasur zbatimin e mundshëm të tyre për bizneset të cilat ndjekin SKK?	SHUMË	PAK	ASPAK	N/A
Përgjigjet	5%	29%	38%	10%
11. Sa të vështirë e shihni zbatimin e SKK 5 të përmirësuar "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jomateriale?"	SHUMË	PAK	ASPAK	N/A
Përgjigjet	5%	43%	24%	10%
12. Në SKK 5 të përmirësuar është shtuar trajtimi kontabël për aktivet materiale të investuara. Sa herë e keni hasur zbatimin e tyre për bizneset të cilat ndjekin SKK?	SHUMË	PAK	ASPAK	N/A
Përgjigjet	0%	24%	43%	10%
13. Në SKK 5 të përmirësuar është shtuar trajtimi kontabël për "emrin e mirë". Sa herë e keni hasur aplikim të tyre për bizneset të cilat aplikojnë SKK?	SHUMË	PAK	ASPAK	N/A
Përgjigjet	5%	14%	57%	10%
Në SKK 5 të përmirësuar janë shtuar kërkesat dhe udhëzimet lidhur me përcaktimin e jetës së dobishme dhe llogaritjen e amortizimit për aktivet materiale dhe jomateriale. Sa herë keni përdorur përcaktime të standardit të ndryshme nga përcaktimet tatimore?	SHUMË	PAK	ASPAK	N/A

Burimi: Pyetësor për profesionistët, Billaci 2015

Konkluzione / Rekomandime

Hipoteza kryesore sipas së cilës, transformimet e regjistrimeve kontabël dhe të sistemeve të informacionit të shoqëruara me mbështetje legale, teknologjike (programe kompjuterike) dhe institucionale kanë efekte pozitive dhe kanë konsoliduar

raportimet financiare të bizneseve të vendit tonë qëndron. Përmirësimet e vazhdueshme të bëra nën kujdesin e institucioneve ndërkombëtare si Banka Botërore, janë një tregues që dëshmon se tashmë Shqipëria po ecën me hapin dhe kërkesat e kohës.

Ndryshimet e dhe përmirësimet e bëra në SKK nuk kanë qenë një refleksion i praktikave të hasura gjatë ushtrimit të profesionit, por një kërkesë për përshtatje me rregullat dhe kornizat e nevojshme për aderimin në BE.

Deri tani rezultojnë punë e mirë institucionale e bërë nga KKK, megjithatë duhet të kishte një sensibilizim dhe një përfshirje më të gjerë të profesionistëve kontabël. Në Shqipëri akoma nuk ekziston një kulturë profesionale e pjesëmarrjes në debatet profesionale edhe pse dëshira ekziston.

Dallimet mes rregullave tatimore dhe kërkesave të standardeve kontabël akoma ekzistojnë dhe influencojnë shumë politikën kontabël të ndërmarrjeve. Nëse kjo është një përparësi apo jo përparësi për ndërmarrjet apo për vetë ekonominë e vendit është një çështje që duhet të studiohet më tej në një punim tjetër.

Nga ana tjetër duhet theksuar që të dhënat e mbledhura në lidhje me praktikën e profesionistëve dhe problemeve që mund të hasen në zbatimin e tyre, ka si kufizim kryesor faktin që njohja dhe zbatimi në praktikë në shkallë të gjerë nuk është bërë akoma dhe finalizimi i efekteve të SKK-ve të përmirësuara do të bëhet me hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2015.

Bibliografia

- Çela, H. (2014): Kontabilitet Finance & Auditim, nr 36, Një informacion i përmbledhur mbi direktiven e re të kontabilitetit 2013/34/EU.
- Çela, H. (2007) Towards application of new standards on accounting and auditing – Albanian challenge
Revista Periodike Kontabilitet Finance & Auditim Cilësia e auditimit (2015): Elementët kryesorë që krijojnë një mjedis për cilësinë e auditimit, Nr 37, Janar.
- Ujkani, M (2012), Zbatimi i Standardeve të Kontabilitetit, Raportimi Financiar dhe Tatimor në Shqipëri.
- Hoxha, E (2014), Vështrim i përgjithshëm mbi rishikimin e SKK-ve.
- Ritchie, I (2012) Sfidat e kontabilitetit në Shqipëri dhe në botë.
- Fortin, H. (November 2013), Building audit quality: the contribution of REPARIS, 12th FCM Annual Conference – Tirana, 4 November 2013.
- Bollano, J. (2012) Arritjet, vështirësitë, sfidat dhe strategjia e KKK për të ardhmen,
- De Simone, L. (2015) Does a Common Set of Accounting Standards Affect Tax-Motivated Income Shifting for Multinational Firms? Stanford Graduate School of Business.
- Procházká, D. (2014): The IFRS as Tax Base: Potential Impact on a Small Open Economy. European Financial and Accounting Journal, vol. 9, no. 4, pp. 59-75.
- Directive 2013/34/EU of the European Parliament and the Council of 26 June 2013 on the annual financial statements, consolidated financial statements and related reports of certain types of undertakings, amending Directive 2006/43/EC of the European Parliament and of the Council and repealing Council directives 78/660/EEC and 83/349/EEC.
- Ligj Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar.
- Urdhri i ministrit Nr. 64, datë 22.07.2014 “Për shpalljen e standardeve të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”.
- [http://kkk.gov.al/foto/uploads/File/SKK%20te%20permiresuara/Enterprise Surveys](http://kkk.gov.al/foto/uploads/File/SKK%20te%20permiresuara/Enterprise%20Surveys) (<http://www.enterprisesurveys.org>), The World Bank.
- <http://www.doingbusiness.org/reports/global-reports/doing-business-2015>
- Lakmal, D, Impact of International Accounting Harmonization (January 29, 2014). Available at SSRN: <http://ssrn.com/abstract=2387327> or <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.2387327>
- Nikhil, C., Das, B., Pramanik, A. (2009) Harmonization of Accounting Standards through Internationalization, CCSNET, vol 2, no.2
<http://ccsnet.org/journal/index.php/ibr/article/viewFile/1149/1145>

KËNAQËSIA E KLIENTIT NË BANKAT TREGTARE QË OPEROJNË NË SHQIPËRI

JASMINA LUMANAJ, PHD(C)

Ndihmës profesor, Fakulteti Ekonomik

Universiteti i Shkodrës « Luigj Gurakuqi », Shkodër, Shqipëri

j_lumani@yahoo.com

PROF. DR. DRITA KRUJA

Lektore, Fakulteti Ekonomik

Universiteti i Shkodrës « Luigj Gurakuqi », Shkodër, Albania

dkruja@unishk.edu.al

ABSTRAKT

Institucionet financiare me performancë të lartë janë gjithmonë në kërkim të nevojave dhe kërkesave të klientëve të tyre, në mënyrë që të mbijetojnë dhe të konkurrojnë suksesshëm në mjedisin e sotëm dinamik të korporatave. Për këtë arsye studiuesit kanë vënë theksin vazhdimisht mbi rëndësinë e kënaqësisë së klientit, besnikërinë dhe mbajtjen e klientit. Qëllimi i këtij studimi është të zhvillojë një kuptim më të mirë teorik dhe praktik të ndikimit që ka cilësia e shërbimit në kënaqësinë e klientit. Ky studim ekzaminon perceptimin e nivelit të cilësisë së shërbimit nga klientët e bankave tregtare që operojnë në Shqipëri dhe efektin që ka mbi kënaqësinë e klientit. Matja e perceptimit të cilësisë së shërbimit bazohet në modelin SERVQUAL të propozuar nga Parasuraman, Zeithaml & Berry (1988), ndërsa matja e kënaqësisë konsumatore është bërë sipas modelit të propozuar nga Lassar, Manolis & Winsor (2000). Rezultatet e kësaj analize tregojnë se cilësia e shërbimit është një paraprirës i rëndësishëm i kënaqësisë së klientit. Nga ky studim duket qartë që menaxheret dhe vendim-marrësit në bankat tregtare të Shqipërisë kërkojnë të përmirësojnë elementet e cilësisë së shërbimit, të cilat përbëjnë kontributin më domethënës në kënaqësinë e klientit.

Fjalë kyç: *cilësi shërbimi, kënaqësia e klientit, bankat tregtare, Shqipëria*

1. Hyrje

Institucionet financiare luajnë një rol jetësor në mirëqenien e një shoqërie. Personat privat ashtu si dhe korporatat përdorin kryesisht institucionet financiare për të menaxhuar kursimet e tyre, për të investuar para dhe për të siguruar hua. Që fillim të viteve '90 kur Shqipëria u transformua nga një vend me ekonomi të centralizuar në një vend me ekonomi tregu, rëndësia e këtyre shërbimeve është rritur vazhdimisht. Një element mjaft i rëndësishëm në fushën e reformave strukturore për të gjitha vendet që u futën në rrugën e ekonomisë së tregut ishte edhe reforma në fushën e sistemit financiar e atij bankar. Reforma në këtë fushë mori një rëndësi të madhe në arritjen e stabilizimit makroekonomik.

Konkretisht si pjesë e një reforme të tillë janë edhe ndryshimet sociale, ekonomike dhe politike që pati vendi ynë pas viteve '92.

Vitet 1991-1992 shënuan krijimin e sistemit të ri bankar nga pikëpamja e organizimit sipas modelit të vendeve perëndimore.

Kuadri ligjor në këtë periudhë bëri të mundur kalimin e sistemit bankar njënivolorë në sistem bankar dynivolorë.

Zhvillimet e viteve të mëvonshme u karakterizuan nga kryerja e reformave në këto banka si dhe krijimi dhe zgjerimi i veprimtarisë bankare nga banka të reja private.

Reforma në sistemin bankar, e cila synonte rritjen e efektshmërisë në tregun bankar, krahas realizimit, fillimisht të ristrukturimit, u mbështet në privatizimin e tyre.

Sot institucionet bankare janë gjithnjë e më shumë konkurrenca me njëra-tjetrën, në mënyra të ndryshme, si ofrimi i produkteve, lloji i produkteve, shërbimeve etj. Pjesë kryesore e konkurrencës midis bankave janë edhe presioni i hyrësve të rinj, ofruesit me kosto më të ulët dhe intensifikimi i konkurrencës.

Ky sektor është zhvilluar si rezultat i investimeve të huaja, bashkimeve, shkrirjeve, shitblerjeve të aksioneve etj.

Në tregun e sotëm, ku konkurrenca është bërë mjaft intensive është e mundur të merret një shërbim i një cilësie gjithnjë e më të lartë. Në një treg me konkurrencë kaq agresive dhe me konsumatorë gjithnjë e më kërkuës, të qëndruarit konkurrues është bërë më shumë sfidues. Kompanitë përpiqen të rrisin strategjitë e tyre në përgjithësi dhe të përshtatin drejtimin e biznesit të tyre me ndryshimet e shpejta në industri të ndryshme.

Rritjet e pritshmërisë së konsumatorit dhe përshtatja me shërbimin e kanë bërë esenciale cilësinë e shërbimit për suksesin e një organizate në shumë tregje, (Parasuraman, Berry and Zeithaml, 1991).

Një pozicion konkurrues tregu dhe një reputacion i mirë i një kompanie mund të përkthehet menjëherë në ndarje dhe përfitim tregu, por ky dallim është fituar shpesh vetëm përmes një angazhimi filozofik të shërbimit, mbështetur nga një vëmendje e zellshme se çfarë duan dhe kanë nevojë klientët. (Zineldin, 2005, p. 331)

Tradicionalisht, një cilësi e mirë shërbimi ka nënkuptuar që autputi të jetë konform specifikimeve që janë përcaktuar në procesin e dizajnimit të shërbimit. Por njerëzit bëhen më të arsimuar dhe kërkuës (Kotler et al, 2005, p. 462-63), dhe kjo ndikon në rritjen e pritshmërive të tyre ndaj performancës së kompanisë dhe cilësisë së produkteve dhe shërbimeve të saj. Tashmë është bërë mjaft e vështirë ta kënaqësh konsumatorin dhe si rrjedhojë është e nevojshme një mbështetje e fortë nga ana e kompanisë.

Sot industria bankare Shqiptare po përballet me një konkurrencë agresive të konsiderueshme. Mjedisi i tregut po përjeton një ndryshim të rëndësishëm në strukturën e tij dhe konkretisht banka të themeluara tashmë po bëhen më të gjëra në qëllimin e tyre, ndërkohë që disa banka të reja po hyjnë në tregun e shërbimeve financiare. Përveç kësaj, avancimi në teknologji i ofron klientëve mënyra të ndryshme për të kryer transaksione bankare.

Tendencat e fundit në Shqipëri kanë qenë drejt një qasjeje të shumëfishtë bankare, p.sh konsumatorët shtrijnë çështjet e tyre financiare në disa banka më mirë sesa të trajtohen për çdo gjë me të njëjtën bankë. Gama e shërbimeve të ofruara ashtu si edhe komoditeti i siguruar nga teknologjitë me vetpërdorim është duke u rritur nëpërmjet konkurrencës në treg. E gjitha kjo përforcon rëndësinë që duhet të kenë për bankat marrëdhëniet e forta me klientët e tyre në mënyrë që t'i mbajnë ato. Sipas Zineldin (2005, p. 331), kompania duhet të krijojë një cilësi shërbimi të mirë dhe ta përmirësojë atë vazhdimisht në mënyrë që ta mbajë të padëmtuar marrëdhënien me klientët. Kjo kërkon që nga ana e bankave duhet të kuptohet mirë se çfarë pret konsumatori nga shërbimi.

2. Rishikimi i literaturës

2.1 Cilësia e Shërbimit

Crosby (1981) e përkufizon cilësinë si lidhje logjike me specifikime fikse dhe kjo përputhet me përkufizimin e Karim (1996), i cili e përkufizon cilësinë si diçka që pajtohet me karakteristikat e produktit që takon nevojat e jashtme të klientëve. Përveç kësaj, cilësia e produktit ndryshon nga cilësia e shërbimit sepse e para është e prekshme, ndërsa e dyta është e paprekshme. Kotler (2003) e përkufizon shërbimin si “çdo sjellje apo veprim të bazuar në kontaktin mes dy palëve: ofruesi dhe marrësi, dhe esencën e këtij procesi reciprok të paprekshëm. Mohamed dhe Shirley (2009) theksuan që cilësia e shërbimit konsiderohet si esenca e një konkurrence strategjike dhe si rrjedhojë bankat duhet të kujdesen për të.

Huseyin, et. Al (2005) beson se bankat duhet të kenë njohuri të mira të karakteristikave dhe avantazheve të cilësisë së shërbimit. Kjo kontribuon në suksesin dhe këmbënguljen e tyre për të konkurruar suksesshëm në mjedisin e bankingut ndërkombëtar. Nga këto përkufizime dalim në përfundim se cilësia e shërbimeve bankare është një vlerësim integruar i

shërbimit të ofruar për klientët e jashtëm. Klientët konsiderohen të jenë individë të pavarur me kërkesa të ndryshme në bazë të së cilës sigurohen shërbime të bazuara në specifikime të caktuara. E gjitha kjo kërkon që banka duhet të tregojë kujdes në procesin e punësimit, duke përzgjedhur punonjës kreativ, me aftësi dhe kualifikime të larta.

Ekzistojnë dy mënyra për të krijuar një model matjeje të cilësisë së shërbimit: e para është një mënyrë e lidhur me kënaqësinë por jo ekuivalente me të dhe e mënyra e dytë lidhet me perceptimin që klienti ka për performancën e shërbimit të përftuar.

Perceptimi i cilësisë së shërbimit tregon diferencën mes perceptimit fillestar që klienti ka për cilësinë e shërbimit dhe nivelit të kënaqësisë së tij dhe performancës aktuale të shërbimit. Nga kjo kuptohet se kënaqësia qëndron mes perceptimit fillestar që klienti ka për cilësinë e shërbimit dhe perceptimit aktual të saj.

Matja e cilësisë së shërbimit dallon nga matja e cilësisë së produktit. Shërbimet janë kryesisht të paprekshme, heterogjene dhe të pandashme (Parasuraman et al, 1985, p. 42). Masa të prekshme mund të identifikohen vetëm në materialet e përdorura për të mbështetur shërbimin dhe objektet fizike të ofruesit. Shërbimi në vetvete është i paprekshëm dhe ndodh shpesh që kemi prodhim dhe konsum të njëkohshëm të tij.

Studiuesit kanë punuar për zhvillimin e sistemeve gjithëpërfshirës për matjen e cilësisë së shërbimit që në vitet 1980. Parasuraman et al (1985, 1988, 1991, and 1994) zhvilloi dhe më tej shqyrtoi modelin SERVQUAL, i cili fillimisht identifikoi dhjetë dimensionet e cilësisë së shërbimit: besueshmëria, përgjegjshmëria, kompetenca, aksesit, mirësjellja, komunikimi, besueshmëria, siguria, mirëkuptimi dhe prekshmëria. Këto dimensione u reduktuan më pas në 5 prej tyre, prekshmëria, besueshmëria, përgjegjshmëria, siguria dhe empatia (Parasuraman, 1991, p. 422). Cilësia e shërbimit matet në bazë të këtyre pesë dimensioneve me një shkallë 22-elementëshe (Parasuraman, 1994, p. 207). Parasuraman et al (1985, p. 44) zhvilloi gjithashtu një modelin e boshllëqeve të cilësisë së shërbimit, i cili asiston modelin SERVQUAL në mënyrë që të identifikojë mospërputhjet në perceptimin e cilësisë së shërbimit nga konsumatori dhe ofruesi i shërbimit. Niveli i shërbimit që pritet nga konsumatori, konsiston në disa komponente. Së pari, eksperiencia e kaluar me ofruesin e shërbimit, ashtu edhe me ofrues të tjerë, është jetike. Ky komponent është i rëndësishëm, veçanërisht në një perspektivë marrëdhënieje. Ajo nënkupton që cilësia e shërbimit duhet të jetë konstante. Për më tepër, nevojat personale të konsumatorëve kontribuojnë në ndërtimin e pritshmërive.

Komunikimi, informimi dhe shkëmbimi i eksperiencave me klientë të tjerë, të njohura me termin *bota e thashethemeve*, i ndihmon klientët të krijojnë një pritshmëri. Së fundi, komunikimi i ofruesit të shërbimit me tregun, nëpërmjet reklamimit, promocionit dhe imazhit të ndërtimit të fushatave influencën pritshmëritë e klientit. Në kohën kur klientët e përdorin shërbimin, ata perceptojnë disa aspekte të cilësisë së shërbimit dhe krahasojnë perceptimet e tyre me pritshmëritë e tyre, në mënyrë që të arrijnë nivelin e kënaqësisë të asaj çka është marrë. Nga ana e ofruesit, duhet të merren parasysh perceptimet menaxheriale për pritshmëritë e klientit, përkthimi i këtyre perceptimeve në specifikime të veçanta të cilësisë së shërbimit, ofrimi i shërbimit në vetvete dhe komunikimet e jashtme me konsumatorët.

Që atëherë, modeli i pesë dimensioneve ka marrë shumë vëmendje nga studiuesit. Shumë studiues e përdorën atë si bazë për punimet e tyre, por ai gjithashtu është kritikuar gjerësisht. Debatet u zhvilluan rreth dimensionalitetit të përcaktuesve të SERVQUAL, vlefshmërisë së tij dhe është argumentuar gjithashtu se modeli nuk lë vend për ndryshime të tjera të arsyeshme (Arasli et al, 2005, p. 514). Gjithashtu është argumentuar se ai nuk është një matës i përdorshëm për gjitha industritë e shërbimit (Sureshchandar et al, 2002, p. 12). Përveç kësaj mangësie, shumë autorë akoma pranojnë dobinë e modelit si bazë kërkimi që duhet të zhvillohet më tej.

2.2 Kënaqësia e klientit

“Kënaqësia është vlerësimi i konsumatorit për produktin ose shërbimin në aspektin nëse ky produkt ose shërbim takon nevojat dhe pritshmëritë e konsumatorit” (Wilson et al, 2008, p. 80). Nëse produktet ose shërbimet nuk përmbushin atë çfarë konsumatorët presin, ata bëhen të pakënaqur dhe si pasojë kërkojnë për oferta më të mira nga konkurrentët. Nëse perceptimet e konsumatorëve përputhen apo shkojnë më tej se pritshmëritë, konsumatorët do të ndjehen pretendues ose të kënaqur respektivisht (Kotler, P., Eöng, V., Saunders, J., Armstrong, G., 2005, p. 10). Klientë të cilët janë vetëm të kënaqur mund të kalojnë lehtë tek konkurrentët kur atyre u ofrohet një produkt apo një shërbim më i mirë dhe një çmim konkurrues. Por, për ata konsumatorë që janë shumë të kënaqur nuk është e lehtë të ndërrojnë, ndërkohë që konsumatorët që janë jashtëzakonisht të kënaqur nga ajo çka i ofrohet bëhen besnik (Kotler et al, 2005, p. 466). Kur konsumatorët janë shumë të kënaqur, ata u flasin të tjerëve në favor të kompanisë së tyre dhe produkteve apo shërbimeve të saj dhe ato nuk janë shumë të influencuar nga konkurrentët (Hansemark, Albinsson, 2004, p. 41), ata nuk janë shumë të ndjeshëm ndaj çmimit, ata bëjnë blerje më shpesh dhe herë pas here blejnë produkte plotësuese (Kotler et al, 2005, p. 466). Ato kompani që mund të arrijnë të mrekullojnë konsumatorët e tyre janë më të mirat. Një faktor kyç i suksesit për to është të mos bëjnë premtime për konsumatorët e tyre, premtime që janë të vështira për t'u mbajtur, por pastaj, mundësisht t'i ofrojnë ata (Kotler et al, 2005, p. 10).

Kënaqësia e klientit është një rezultat i pritshmërive të konsumatorit dhe perceptimit të cilësisë së shërbimit. Sipas Karten (2009), niveli i kënaqësisë së konsumatorit përcaktohet nga çfarë konsumatori pret dhe performancës së kompanisë. Edhe pse kënaqësia ndikohet nga shumë faktorë të ndërlidhur, autori e ilustron atë nëpërmjet një formule të thjeshtë, e cila tregon se niveli i kënaqësisë së konsumatorëve mund të ndikohet nga ndryshime si në eksperiencën e tyre ashtu edhe në performancën e kompanisë (Karten, 2009), çka aktualisht është ajo çfarë konsumatorët perceptojnë në terma të produkteve dhe shërbimeve që u ofrohen.

Kënaqësia konsumatorë. Performanca e kompanisë (Perceptimi i konsumatorëve)/Pritshmëritë e konsumatorit

Një koncept tjetër shumë i lidhur me kënaqësinë është cilësia e shërbimit (Zeithaml, V.A., Bitner M. J., Gremler D. D., 2006, p.106). Është argumentuar vazhdimisht mes studiuesish për dallimin dhe lidhjen mes cilësisë së shërbimit dhe kënaqësisë së konsumatorit. Kërkuesit ndajnë të njëjtin mendim që të dy konceptet janë të ndryshëm (Lassar, E.M., Manolis, Ch., Eïnsor, R.D., 2000, p. 183). Koncepti i kënaqësisë është më i zgjeruar në krahasim me cilësinë e shërbimit, që është një term më specifik dhe mund të matet nga disa dimensione (Zeithaml et al, 2006, p. 106).

Sipas Parasuraman (1985, 1988; Lassar et al, 2000, p. 183) cilësia e shërbimit “është një përcaktuese e pjesshme e kënaqësisë”. Në marrëdhëniet afat-gjata, konsumatorët kanë një ndjenjë kumulative rreth kënaqësisë, e cila është krijuar nga çdo perceptim cilësie individuale (Leverin, Liljander, 2006, p. 234-35).

Disa studiues mendojnë se kënaqësia e klientit mund të matet. P.sh. Caepiel (1974) sugjeron përdorimin e matësve me kufij duke ruajtur përgjigjet e konsumatorëve për vetitë e ndryshme të produkteve apo shërbimeve. Kuo (1996) dalloi shtatë faktorë që ndikojnë kënaqësinë e klientit: përmbajtja e shërbimit, çmimi, komoditeti, imazhi i korporatës, pajisjet, stafi dhe procedura. Organizatat e shërbimit kanë filluar të fokusohen në perceptimin e klientit për cilësinë e shërbimit sepse kjo ndihmon në zhvillimin e strategjive që çojnë në kënaqjen e klientit Saravanan & Rao, (2007, p437).

3. Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Çështjet kryesore që diskutohen në këtë kërkim janë cilësia e shërbimit dhe kënaqësia e klientit duke përdorur modelin SERVQUAL në kontekstin bankar. Në këtë studim do i përgjigjemi pyetjeve:

Si e perceptojnë konsumatorë cilësinë e shërbimit në sektorin bankar?

A janë të kënaqur konsumatorët me cilësinë e shërbimit të ofruar nga sektori bankar?

Qëllimi i këtij studimi është të zhvillojë një kuptim më të mirë teorik dhe praktik të ndikimit që ka cilësia e shërbimit në kënaqësinë e klientit. Ky studim teston nëpërmjet modelit SERVQUAL sektorin bankar duke matur e cilësinë e shërbimit dhe kënaqësinë e klientit. Bazuar në gjetjet e bëra gjatë rishikimit të literaturës, ne besojmë se cilësia e shërbimit është një paraprirëse e kënaqësisë. Si rrjedhojë hipoteza bazë është:

H1. Cilësia e shërbimit influencon direkt dhe pozitivisht kënaqësinë e klientit.

Studimi u krye në Shkodër, qytet i cili ka 13 degë të bankave të ndryshme tregtare. Anketimi ishte i bazuar në web dhe linku u dërgua me e-mail 200 klientëve të bankave të ndryshme, përfutës të shërbimeve të ndryshme bankare (pagamarrës, depozitues, kreditues etj). Vetëm 160 persona plotësuan pyetësorin duke patur kështu një rend kthimi përgjigjesh prej 80%. Pyetësori kishte 3 pjesë. Pjesa e parë e pyetësorit shërben për të matur cilësinë e shërbimit të vlerësuar nga klientët. Pjesa e dytë mat kënaqësinë konsumatore dhe e treta variabilet demografikë.

Variabilet e Matur

Variabli i pavarur - Cilësia e shërbimit.

Ky matës bazohet në versionin e modifikuar të SERVQUAL të propozuar nga Parasuraman et al. (1988), i cili konsiston në 22 elementë, të grupuara në pesë dimensionet e Cilësisë së Shërbimit, përkatësisht *Prekshëmëria* (sa moderne janë pajisjet e bankës, sa tërheqëse janë objektet fizike të bankës, sa të aftë duken punonjësit e bankës, sa tërheqëse janë materialet që lidhen me shërbimin), *Besueshmëria* (kur banka premton të bëjë diçka në një kohë të caktuar, ajo e bën atë, kur klienti ka problem banka tregon interesim të sinqertë për zgjidhjen e tij, banka kryen shërbimin në mënyrën e duhur që herën e parë, banka i ofron shërbimet e saj në kohën e duhur, banka këmbëngul në të dhënat pa gabime), *Përgjegjshmëria* (punonjësit e bankës tregojnë saktësisht se kur do të kryhet shërbimi, punonjësit e bankës ofrojnë shërbim të shpejtë, punonjësit e bankës kanë gjithmonë dëshirë për t’ju ndihmuar, punonjësit e bankës nuk janë kurrë aq të zënë që t’i përgjigjen kërkesave tuaja), *Siguria* (sjellja e punonjësve të bankës rrënjësorë tek klientët, me bankën ju ndiheni të sigurt për transaksionet që kryeni, punonjësit e bankës janë vazhdimisht të sjellshëm me ju, punonjësit e bankës kanë njohuritë e duhura për t’ju përgjigjur pyetjeve tuaja), *Empatia* (banka ofron vëmendje individuale, banka ka orare pune të përshtatshme për të gjithë konsumatorët, banka ka punonjës që ju japin vëmendje personale, banka ka përzemër interesin tuaj më të mirë, punonjësit e bankës i kuptojnë nevojat specifike të klientëve). Këto elemente vlerësohen me shkallën e Likertit 7 pikëshe, ku 1=nuk pajtohem absolutisht dhe 7=pajtohem fuqishëm

Variabli i Varur- Kënaqësia e konsumatorit

Kënaqësia e konsumatorit matet sipas modelit të propozuar nga Lassar, Manolis & Eïnsor (2000). Ky model përmban 7 elementë, ku 4 janë të lidhura me kënaqësinë nga shërbimet bankare (llogari rrjedhëse, depozita bankare, pagesat, transfertat e parave) dhe 3 të tjera janë të lidhura me kënaqësinë nga sjellja e punonjësve (mirësjellja e stafit të pritjes, mirësjellja e personelit ndihmës dhe mirësjellja e menaxherëve)

Vlefshmëria e SERVQUAL për sektorin bankar

Shkalla SERVQUAL u testua për vlefshmërinë e saj nëpërmjet analizës korrelative për secilin nga 5 dimensionet me vlerësimin e përgjithshëm të cilësisë së shërbimit dhe kënaqësinë konsumatore. Nga tabela shohim që lidhjet korrelative janë sinjifikante, pra mund të konkludojmë mbi vlefshmërinë e përdorimit të kësaj shkalle për sistemin bankar në Shqipëri.

TABELA NR. 1: LIDHJET KORRELATIVE MES VARIABILEVE

		Prekshmëria	Besueshmëria	Përgjegjshmëria	Siguria	Empatia
Kënaqësia konsumatore	Korrelacioni	.486**	.681**	.749**	.740**	.606**
	Pearson Sig. (2-tailed)	.000	.000	.000	.000	.000
	N	160	160	160	160	160
Cilësia	Korrelacioni	.707**	.946**	.940**	.905**	.865**
	Pearson Sig. (2-tailed)	.000	.000	.000	.000	.000
	N	160	160	160	160	160

** . Korrelacioni është sinjifikant tek niveli 0.01 (2-fytyra).

4. Analizë, interpretim të dhënash

4.1 Karakteristikat demografike të të anketuarve

Tabela 2 paraqet të dhënat demografike të anketuarve. Siç shihet 40% e të anketuarve ishin meshkuj, ndërsa 60% ishin femra. Pjesa më e madhe e të anketuarve ishin me arsim të lartë. Kjo kategori përbën 53.4% të anketuarve, duke pasuar me të anketuarit me arsim master, të cilët përbëjnë 25.9% të anketuarve dhe me arsim doktoral 13.8% të anketuarve. Niveli i të ardhurave i 42.1 % të anketuarve është 40.000 – 59.999 Leke, duke pasuar me nga 17.5% të anketuarve për nivelet 60.000 – 79.999 dhe 80.000 – 99.999 Lekë

TABELA NR. 2: TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

Niveli i te ardhurave (Lekë)	Përqindja
Më pak se 10.000	3.5
10-000 – 19.999	1.8
20.000 – 39.999	15.8
40.000 – 59.999	42.1
60.000 – 79.999	17.5
80.000 – 99.999	17.5
Më shumë së 100.000	1.8
Total	100
Arsimi	
Shkollë e mesme	6.9
Universitar	53.4
Master	25.9
Doktoraturë	13.8
Total	100
Gjinia	
Mashkull	40
Femër	60
Total	100

4.2 Vlerësimi i cilësisë së shërbimit

Për mbledhjen e të dhënave lidhur me perceptimin e cilësisë së shërbimit që kanë klientët u përdor një pyetësor, i cili përmbante 22 pohime të përshtatshme për matjen e perceptimeve të klientëve rreth performancës së cilësisë së shërbimit. Nga këto 22 pohime, katër të parat i përkasin dimensionit të preksshmërisë pesë i përkasin dimensionit të besueshmërisë, katër i përkasin dimensionit të përgjegjshmërisë, katër i përkasin dimensionit të sigurisë dhe pesë të fundit i përkasin dimensionit të empatisë.

TABELA NR. 3: PËRMBLEDHJE E STATISTIKAVE PËRSHKRUESE TË DIMENSIONEVE TË CILËSISË SË SHËRBIMEVE

Dimensionet	N	Minimum	Maksimum	Mesatare	Deviacioni standard
Cilësia e përgjithshme	160	1.43	7.00	5.1016	1.13213
Prekshmëria	160	2.00	7.00	5.0333	1.15299
Besueshmëria	160	1.40	7.00	5.0017	1.34297
Përgjegjshmëria	160	1.00	7.00	5.1597	1.46437
Siguria	160	1.00	7.00	5.2972	1.28261
Empatia	160	1.00	7.00	5.0158	1.19977
Valid N (listës)	160				

Nga statistikave e përmbledhura në tabelën 3 vihet re që vlerësimin më të lartë për cilësinë e shërbimit e merr dimensionin i katërt, *siguria*. Ky dimension merr një vlerësim mesatar 5.29, çfarë tregon se klientët në përgjithësi vlerësojnë sigurinë e tyre dhe shërbimeve që marrin nga bankat. Ata ndihen të sigurt dhe punonjësit e bankave arrijnë të rrenjosin konfidencë tek këta konsumatorë. Përkundrazi, dimensionin e dytë merr vlerësimin më të ulët mesatar 5.0017. Çfarë nënkupton se klientët nuk e vlerësojnë mjaftueshëm mundësinë që punonjësit e bankave të zgjidhin problemet e tyre. Për të përmirësuar vlerësimin e këtij dimensionin punonjësit duhet të kenë trajnim të veçantë për njohjen gjithnjë e më të mirë të produkteve bankare në tërësi, për sjelljen e tyre dhe gatishmërinë në përcimin e njohurive të tyre.

Siç shihet në tabelën 4, në dimensionin e preksshmërisë të anketuarit vlerësojnë më tepër *aftësinë e punonjësve*, mesatarisht me vlerësim 5.1, duke vazhduar me një vlerësim mesatar prej 5.08 për *objektet fizike tërheqëse të bankës*. Në dimensionin e besueshmërisë, të anketuarit vlerësojnë më së shumti *punën pa gabime të bankës* duke e vlerësuar me një mesatarë 5.27, pasuar me *ofrimin e shërbimeve në kohën e duhur* me mesatare 5.05. Në dimensionin e përgjegjshmërisë merr vlerësimin më të lartë *dëshira e punonjësve për të ndihmuar klientët*. Në dimensionin e sigurisë merr vlerësimin më të lartë *sjellja e mirë e punonjësve*, por duhet të kihet kujdes me *besimin që i transmetohet klientëve*, meqë ky pohim merr vlerësimin më të ulët të dimensionit përkatës 5.08.

Në dimensionin e ndjeshmërisë merr vlerësimin më të lartë *vëmendja individuale që banka ofron për klientin*, dhe vlerësohet më pak me 4.75 *sa përzemër e ka banka interesin më të mirë të klientit*.

TABELA NR. 4: STATISTIKA PËRSHKRUESE TË DIMENSIONEVE TË CILËSISË SË SHËRBIMEVE

	Minimum	Maksimum	Mesatare	Deviacioni standard
Dimensionin e preksshmërisë				
Banka XYZ ka pajisje moderne	1	7	5.07	1.425
Objektet fizike të Bankës XYZ kanë pamje tërheqëse	1	7	5.08	1.488
Punonjësit e Bankës XYZ duken mjaft të aftë	1	7	5.1	1.515
Materialet e Bankës XYZ që lidhen me shërbimin (fletushka, broshura, etj.) janë dukshëm tërheqëse	1	7	4.88	1.627
Dimensionin e besueshmërisë				
Kur Banka XYZ premtos të bëjë diçka në një kohë të caktuar, ajo e bën atë	1	7	4.8	1.571
Kur ju keni një problem, Banka XYZ tregon interesim të sinqertë për zgjidhjen e tij	1	7	4.88	1.658
Banka XYZ e kryen shërbimin në mënyrën e duhur që herën e parë	1	7	5.03	1.551
Banka XYZ i ofron shërbimet e saj në kohën e duhur	1	7	5.05	1.419
Banka XYZ këmbëngul në të dhënat pa gabime	1	7	5.27	1.706
Dimensionin e përgjegjshmërisë				
Punonjësit e Bankës XYZ ju tregojnë saktësisht se kur do të kryhet shërbimi	1	7	5.17	1.743
Punonjësit e Bankës XYZ ju ofrojnë shërbim të shpejtë	1	7	5.27	1.518

Punonjësit e Bankës XYZ kanë gjithmonë dëshirë për t'ju ndihmuar	1	7	5.4	1.509
Punonjësit e Bankës XYZ nuk janë kurrë aq të zënë që t'i përgjigjen kërkesave tuaja	1	7	4.88	1.609
Dimensioni i sigurisë				
Sjellja e punonjësve të Bankës XYZ rrënjës besim tek klientët	1	7	5.08	1.629
Me bankën XYZ ju ndiheni të sigurt për transaksionet që kryeni	1	7	5.39	1.509
Punonjësit e Bankës XYZ janë vazhdimisht të sjellshëm me ju	1	7	5.6	1.543
Punonjësit e Bankës XYZ kanë njohuritë e duhura për t'ju përgjigjur pyetjeve tuaja	1	7	5.12	1.508
Dimensioni i empatisë				
Banka XYZ ju ofron vëmendje individuale	1	7	5.23	1.466
Banka XYZ ka orare punë të përshtatshme për të gjithë konsumatorët	1	7	5.15	1.818
Banka XYZ ka punonjës që ju japin vëmendje personale	1	7	5	1.629
Banka XYZ ka përzemër interesin tuaj me të mirë	1	7	4.75	1.503
Punonjësit e Bankës XYZ i kuptojnë nevojat tuaja specifike	1	7	4.95	1.489

4.3 Vlerësimi i kënaqësisë së klientit

Në tabelën 5 jepen rezultatet e pyetësorit të lidhura me kënaqësinë e konsumatorit. Të dhënat ndahen në dy grupe sipas kënaqësisë ndaj produkteve bankare dhe kënaqësisë ndaj mirësjelljes së stafit.

TABELA NR 5: STATISTIKA PËRSHKRUESE TË KËNAQËSISË KONSUMATORE

	N	Minimum	Maksimum	Mesatare	Deviacioni standard
Kënaqësia nga produktet bankare	160	2.20	7.00	4.8875	1.17796
Kënaqësia nga mirësjellja e stafit	160	1.00	7.00	5.5611	1.42680
Kënaqësia konsumatore	160	2.10	7.00	5.2243	1.17787

Shohim që mesataren më të ulët të vlerësimit e ka kënaqësia nga produktet bankare, prandaj më poshtë kemi të detajuar tabelën dhe analizën e vlerësimit.

TABELA NR. 6: STATISTIKA PËRSHKRUESE TË ELEMENTËVE PËRBËRËS TË KËNAQËSISË KONSUMATORE

	Minimum	Maksimum	Mesatare	Deviacioni standard
Shërbimet bankare				
Sa të kënaqur jeni me Llogaritë rrjedhëse.	3	7	5.49	1.292
Sa të kënaqur jeni me Depozitat bankare	2	7	4.62	1.617
Sa të kënaqur jeni me shërbimin e Pagesave	2	7	5.35	1.560
Sa të kënaqur jeni me Transfertat e parave	1	7	5.23	1.637
Lehtësirat e kreditimit	1	7	3.78	1.585
Sjellja e punonjësve				
Sa të kënaqur jeni me mirësjelljen e stafit të pritjes.	1	7	5.62	1.606
Sa të kënaqur jeni me mirësjelljen e personelit ndihmës.	1	7	5.58	1.453
Sa të kënaqur jeni me mirësjelljen e menaxherëve	1	7	5.48	1.557

Kjo rubrikë është e ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë tregon kënaqësinë e klientëve lidhur me shërbimet bankare. Vlerësimin më të lartë mesatar (5.49) e merr Llogaria Rrjedhëse. Klientët janë të kënaqur më tepër me llogarinë rrjedhëse dhe janë më pak të kënaqur me depozitat bankare, të cilat vlerësohen mesatarisht me 4.62. Ky vlerësim vjen si rezultat i ndjeshmërisë që kanë klientët me fitimin e tyre. Klientët shprehen më pak të kënaqur me depozitat ndikuar nga normat jo të mira të interesave, ndërsa shprehen të kënaqur për llogaritë rrjedhëse meqë prej këtij shërbimi nuk presin fitim monetar. Vlerësimin më të dobët e merr *lehtësia e kreditimit*, e cila vlerësohet me 3.78.

Sipas të anketuarve procedurat që banka ndjek për dhënien e një kredie janë shumë të gjata, shoqërohen me shumë burokraci, kërkohet shumë dokumentacion dhe për më tepër është një procedurë që shoqërohet me shpenzime. Ky rezultat patjetër ka arsytet e veta, duke vlerësuar produktin e kredisë si produktin me risk më të lartë që ofron banka. Sigurisht që banka duhet të kryej procedurat përkatëse që të jetë e mbrojtur ndaj kredive të këqija, por ato duhet gjithashtu t'i rivlerësojnë

këto procedura duke i bërë më të shpejta dhe me elastike dhe të ruajnë në këtë mënyrë nivelin e kënaqësisë që klientët kanë për bankat.

Pjesa e dytë tregon kënaqësinë e klientit lidhur me sjelljen e punonjësve. Të anketuarit vlerësojnë më shumë (5.62) mirësjelljen e stafit të pritjes, kjo si rezultat i trajnimeve të herëpashershme që kjo kategori punonjësish bën për pritjen sa më të mirë të klientëve. Stafit i pritjes, për vetë specifikën që ka, është i specializuar për mënyrat më të mira të sjelljes. Në këtë aspekt duhet të tregojnë kujdes menaxherët, të cilët marrin vlerësimin më të ulët lidhur me kënaqësinë që përçojnë me mënyrën e sjelljes së tyre (5.48)

Kontributi i cilësisë mbi kënaqësinë konsumatore.

Analiza e regresionit linear ku variabël i pavarur ishte cilësia dhe variabël i varur kënaqësia konsumatore tregoi që R^2 ishte 0.563, i cili tregon që 56.3% e ndryshimeve në kënaqësi shpjegohen nga perceptimi i cilësisë së shërbimit.

Modeli i regresionit rezultoi statistikisht domethënës ($F(1,159) = 74.795$; $p < 0,001$). Pra vlera e R^2 nuk është rezultat i shansit; variabilet e pavarur janë në gjendje për të shpjeguar variacionin në variabilin e varur. Lidhja ndërmjet variabëlilit të pavarur e atij të varur jepet nëpërmjet ekuacionit të mëposhtëm: Kënaqësia konsumatore = $1.241 + 0.781$ (cilësia e shërbimeve)

Koeficienti i regresionit është pozitiv (0,781) dhe tregon për një lidhje pozitive ndërmjet variabëlilit të pavarur dhe atij të varur. Do të thotë se me rritjen e nivelit të perceptimit të cilësisë së shërbimeve do të kemi rritje të kënaqësisë konsumatore.

Po kështu testi statistikor për kontrollin e koeficienteve individual të regresionit tregon që këto koeficiente janë të ndryshëm nga zero $t=8.648$ dhe $p < 0.001$, prandaj mund të konkludojmë që variabli jep kontribut domethënës në model dhe hipoteza bazë pranohet.

TABELA NR. 7: PËRMBLEDHJE E MODELIT TË REGRESIONIT LINEAR

Modeli	R	R ²	R ² i rregulluar	Gabimi standard i vlerësimit		
1	.750 ^a	.563	.556	.78511		
a. Variabli i pavarur: (konstantja), Cilësia e shërbimeve						
ANOVA ^a						
Model	Shuma e katrorëve	df	Mesataria në katrorë	F	Sig.	
1	Regresioni	46.103	1	46.103	74.795	.000 ^b
	Mbetjet	35.751	159	.616		
	Totali	81.855	160			
a. Variabli i varur: Kënaqësia konsumatore						
b. Variabli i pavarur: (Konstantja), Cilësia e shërbimeve						
Koeficiente:						
Modeli	Koeficientet e pastandardizuar		Koeficientet e standardizuar		t	Sig.
	Gabimi standard	Beta				
1	(Konstantet)	1.241	.472		2.631	.011
	Cilësia	.781	.090	.750	8.648	.000
a. Variabli i varur: Kënaqësia konsumatore						

5. Konkluzione/ Rekomandime

Nga vetë natyra, shërbimi bankar i jep mundësi klientëve të kërkojnë cilësinë më të lartë të mundur dhe për të arritur këtë është shumë e rëndësishme që banka të jetë shumë afër klientit, të dijë nevojat e tij aktuale dhe të parashikojë të ardhmet, të kuptojë pritshmëritë dhe perceptimet e tij.

Matja e cilësisë së shërbimit bankar duhet të bazohet në cilësinë e perceptuar sepse cilësia e shërbimit është e paprekshme dhe heterogjene.

Rezultatet e studimit tregojnë se cilësia e shërbimit është një faktor mjaft i rëndësishëm që ndikon pozitivisht kënaqësinë e klientit në Shqipëri. Në të njëjtin rezultat kanë arritur edhe studiues të tjerë, të cilët kanë studiuar lidhjen mes cilësisë së shërbimit (Andaleeb and Conëay, 2006; Gotlieb et al., 1994; Buttle, 1996; Zeithaml and Bitner, 1996; Lee et al., 2000; Zeithaml and Bitner, 2003). Të pesë dimensionet e cilësisë së shërbimit, preکشmëria, besueshmëria, përgjegjshmëria, siguria dhe empatia ndikojnë në kënaqësinë e klientit. Kjo rrit nevojën e menaxherëve të bankave që të rrisin cilësinë nëpërmjet këtyre

pesë dimensioneve duke i analizuar herë pas here, duke studiuar tregun ekzistues dhe sidomos duke parashikuar nevojat dhe dëshirat, pritshmëritë dhe perceptimet e ardhshme të klientëve ekzistues dhe atyre potencialë.

Në kërkimet e mëtejshme studimi duhet të shtrihet dhe në analizën e pritshmërive konsumatore duke analizuar boshllëqet e cilësisë dhe rekomanduar zgjidhje për reduktimin e tyre.

Bibliografia

- Arasli, H., Mehtap-Smadi, S., & Turan Katircioglu, S. (2005). Customer service quality in the Greek Cypriot banking industry. *Managing Service Quality: An International Journal*, 15(1), 41-56.
- Arasli, H., Turan Katircioglu, S., & Mehtap-Smadi, S. (2005). A comparison of service quality in the banking industry: Some evidence from Turkish-and Greek-speaking areas in Cyprus. *International Journal of Bank Marketing*, 23(7), 508-526.
- Crosby, L. A., Evans, K. R., & Coëles, D. (1990). Relationship quality in services selling: an interpersonal influence perspective. *The journal of marketing*, 68-81.
- Hansemark, O. C., & Albinsson, M. (2004). Customer satisfaction and retention: the experiences of individual employees. *Managing Service Quality: An International Journal*, 14(1), 40-57.
- Hossain, M., & Leo, S. (2009). Customer perception on service quality in retail banking in Middle East: the case of Qatar. *International Journal of Islamic and Middle Eastern Finance and Management*, 2(4), 338-350.
- Kotler, P., Armstrong, G. (1999) Principles of Marketing. *U. SR Prentice-Hall (Eds.)*, 8.
- Kotler, P., Wong, V., Saunders, J., Armstrong, G. (2005), Principles of Marketing, fourth European edition, Pearson Prentice Hall.
- Kuo, C. T. (1996). Study on Customer Satisfy of Swimming Pool-Using the Sample of National Chung Cheng University's Swimming Pool. *Journal of Physical education*, 49-68.
- Lassar, W. M., Manolis, C., & Winsor, R. D. (2000). Service quality perspectives and satisfaction in private banking. *Journal of services marketing*, 14(3), 244-271.
- Leverin, A., & Liljander, V. (2006). Does relationship marketing improve customer relationship satisfaction and loyalty?. *International journal of bank marketing*, 24(4), 232-251.
- Newman, K., & Cowling, A. (1996). Service quality in retail banking: the experience of tēo British clearing banks. *International Journal of Bank Marketing*, 14(6), 3-11.
- Parasuraman, A., Berry, L. L., & Zeithaml, V. A. (1991). Refinement and reassessment of the SERVQUAL scale. *Journal of retailing*.
- Parasuraman, A., Berry, L. L., & Zeithaml, V. A. (1993). More on improving service quality measurement. *Journal of retailing*, 69(1), 140-147.
- Parasuraman, A., Zeithaml, V. A., & Berry, L. L. (1985). A conceptual model of service quality and its implications for future research. *the Journal of Marketing*, 41-50.
- Parasuraman, A., Zeithaml, V. A., & Berry, L. L. (1988). Servqual. *Journal of retailing*, 64(1), 12-40.
- Parasuraman, A., Zeithaml, V. A., & Berry, L. L. (1994). Alternative scales for measuring service quality: a comparative assessment based on psychometric and diagnostic criteria. *Journal of retailing*, 70(3), 201-230.
- Sureshchandar, G. S., Rajendran, C., & Anantharaman, R. N. (2002). Determinants of customer-perceived service quality: a confirmatory factor analysis approach. *Journal of services Marketing*, 16(1), 9-34.
- Zeithaml, V. A., Bitner, M. J., & Gremler, D. D. (2006). Services marketing: Integrating customer focus across the firm. McGraw-Hill.
- Zineldin, M. (2005). Quality and customer relationship management (CRM) as competitive strategy in the Sēedish banking industry. *The TQM magazine*, 17(4), 329-344.

KONTROLLI DOGANOR I BAZUAR NË AUDITIM – KRAHASIMI I STANDARTIT 6.6 DHE 6.10 NGA KONVENTA E RISHIKUAR E KYOTOS ME ASPEKTIN LIGJOR DHE PRAKTIKAT E KONTROLLIT PAS IMPORTUESE NGA DOGANA E KOSOVËS

MSC. MENTOR GASHI

Studenti i Doktoratures ne UET

ABSTRAKT

Në këtë artikull kemi shqyrtuar dokumente relevante ndërkombëtare tregtare që kanë paraqitur Post Clearance Auditin (PCA) apo Kontrolli pas zhdoganimit si mekanizëm të kontrolli doganor pas zhdoganimit të mallit, kjo me qëllim që të lehtësohet qarkullimi ndërkombëtar tregtar. Lehtësimin e lëvizjes ndërkombëtare të mallrave e realizojnë duke e bërë zvogëlimin e numrit të kontrolleve në kufi, apo vetëm kontrollin e bazuar në nivel të riskut, në këtë mënyre duke krijuar hapësirë që kontrollin doganor të realizojnë pas zhdoganimit të mallrave. Kontrolli doganor pas zhdoganimit të mallrave apo pas një periudhe të caktuar tek kompania bëhet duke u bazuar në auditim. Kontrolli doganor i bazuar në auditimi i referohet standardit 6.6 dhe 6.10 në kapitullin 6 të Marrëveshjes së Rishikuar të Kyotos. Ku këto standarde i japin mundësi mekanizmit të kontrollit nga dogana të bëhet një kontroll doganore jo e zakonshme, me e zgjedhur sikur një auditim, dhe që të ketë të drejtën e kontrollit të gjithë sistemit komercial të kompanisë duke pasur në disponim dokumentet tregtare dhe gjithë informatat e nevojshëm, njëkohësisht të drejtën për të ushtruar kontroll tek objekti afarsit i tregtarit dhe verifikim fizik të mallrave. Në këtë artikull ne kemi shqyrtuar dhe krahasuar dokumentet që paraqesin nevojën, rëndësinë dhe praktikave të kontrollit pas zhdoganimit, respektivisht standardet 6.6 dhe 6.10 me aspektin ligjor dhe praktika e përdoruar nga kontrolle pas importuese e Doganës së Kosovës. Gjatë krahasimit është gjetur përputhshmëri e lart në mes tyre, ku aspekti ligjor, respektivisht neni 82 i kodit doganor dhe të akcizave të Kosovës lejon dhe ka përcaktuar të drejtën e kontrollit pas importit, po ashtu edhe gjatë krahasimit të fazave dhe praktikave të kontrollit, nga organi i caktuar i kontrolli pas zhdoganimit në kuadër të doganës së Kosovës është paraqitur përputhshmëri e plotë e praktikave që përdoren për kontrollin doganor të bazuar në auditim, sipas dokumenteve të shqyrtuara.

Fjalë kyç: *Post clearance audit, kontrolli doganor, standardet 6.6 dhe 6.10 sipas Kyotos, lehtësira tregtare, zbulimin e shmangieve nga detyrimet doganore.*

Hyrja

Kontrolle pas importuese ose sipas emërimit ndërkombëtar Post Clearance Audit (PCA), janë duke u bërë mekanizëm i fuqishëm në doganat moderne, të cilët kanë qëllimet thelbësor të lehtësojnë qarkullimin e tregtisë ndërkombëtare dhe njëkohësisht të avancojnë respektimin e procedurave doganore dhe të mos lejojnë shmangia nga detyrime doganore. Siç do të paraqesim me poshtë në vazhdim të këtij artikulli, nga marrëveshja e Kyotos gjejmë parimet për zhvillimi e e tij mekanizmi, po ashtu edhe nga Blueprints për doganën që është udhëzuese praktike dhe që paraqet kritere të qarta të bazuara në praktikën më të mira të BE-së, i cili si i tillë është zhvilluar në vitin 1998 për të ndihmuar autoritetet doganore të vendeve të Evropës qendrore dhe lindore për tu përgatitur që të operojë në përputhje me legjislacionin dhe standardet e EU-së duke marrë parasysh hyrjen e tyre në EU në të ardhmen, në këtë dokument gjejmë objektivat të ndërtuar për zhvillimin e kontrollit pas importit, ku në këtë artikull kemi krahasuar me ligjin dhe praktikën e kontrollit pas importi që ushtrohen nga Dogana e Kosovës, ku dhe janë gjetur përputhshmëri relativisht të lart, për funksionimin efektiv të kontrollit pas importuese.

Rishikim Literature

Organizata Botërore e Doganave (OBD), duke e kuptuar nevojën e përshtatjes së ekonomisë së rritur botërore, ka theksuar në Konventën e Rishikuar të Kyotos nevojën që administratat doganore të lëvizin drejtë kontrolleve pas importuese për të lehtësuar tregtinë, e cila gjithashtu përfshinë edhe tranzicionin drejtë “kontrolleve të bazuara në auditim” që përfaqëson auditimin e sistemeve të brendshme të tregtarëve dhe kontrollet pasi që ato ndërlihen me Doganën.

Standardet në vijim që gjenden në **Konventën e Rishikuar të Kyotos** janë të një rëndësie të veçantë, si:

Standardi 6.6: Sistemet e kontrolleve doganore duhet të përfshijnë kontrollet e bazuara në auditim; dhe

Standardi 6.10: Dogana duhet të bëjë vlerësimin e sistemeve komerciale të tregtarëve kur ato sisteme ndikojnë në

operacionet Doganore për të garantuar përmbushjen e nevojave Doganore.

Njëkohësisht për të zhvilluar shërbimet të kontrollit dhe auditimit efektiv post dokumentar i cili lejon administratat doganore të implementojnë detyrat e veta (zhdoganimin dhe kontrollin e mallrave, arkëtimin e të hyrave) dhe lehtësimin e tregtisë, duke mbajtur ekuilibër ndërmjet lehtësimit të tregtisë dhe kontrollit efektiv doganor, përcaktohet edhe nga **Blueprinti për Doganat (blueprints for customs)** i cili shërben si udhëzues praktik për vendet që angazhohen për të bërë reforma doganore dhe për të bërë modernizimin e doganave të tyre. Në këtë rast nëse e bëjmë krahasimin në mes këtyre dy dokumenteve ndërkombëtare me legjislacionin doganor të Kosovës, po ashtu gjejmë se edhe Kodi Doganor dhe i Akcizave i Kosovës 03/L-109, në nenin 82. Paragrafi 1, përcakton aspektin ligjor, të drejtën për kontrollin e personave dhe subjekteve që kanë të bëjnë në mënyrë të drejtpërdrejt apo indirekte me importin, eksportin apo mallrat doganore.

Konventa e Kyotos, **Kapitulli 6/7.2**, paraqet qëllim e funksionimit të Kontrollit pas zhdoganimit, ku thotë: për të menaxhuar rritjen mbare botërore në tregtinë dhe njëkohësisht për të siguruar lehtësira më të mëdha tregtare, dogana mbështetet në kontrollet e bazuara të auditimit, duke përdorur sistemet komerciale të tregtarëve. Këto kontrolle mund të ndryshojnë nga një kontroll të thjeshtë e pas-zhdoganimit. Kontrollet e bazuara në auditim nuk e përjashtojnë ekzaminimin fizik të mallrave. Për të siguruar besueshmërinë e sistemeve komerciale të tregtarëve, duhet ndjekur parimet e kontabilitetit të pranuar përgjithësisht. Auditimi pas-zhdoganimit fokusohet tek personat dhe kompanitë e përfshira në qarkullimin ndërkombëtar të mallrave. Është një mjet efektiv për kontrollin doganor sepse jep një pasqyrë të qartë, gjithëpërfshirëse, të transaksioneve që janë relevante për doganën, të cilat këto transaksione reflektojnë nga librat dhe regjistrat tregtarë. Në të njëjtën kohë administratat doganore ofrojnë masat e lehtësimit tregtar në formën e procedurave të thjeshtëzuar. Auditimet doganore tek kompanitë kryhet me qëllime të verifikimit të: vlerës së mallit, origjinës, klasifikimit tarifor, pagesave të detyrimeve doganore, programet e lejimeve etj. Auditimet mund të kryhet në mënyrë të vazhdueshme, ciklike ose sipas rastit. Auditimi nga dogana planifikohet për çdo vite duke pasur parasysh resurset si dhe kohën standarde në disponim për të përfunduar kontrollin e përcaktuar. Auditimi pas zhdoganimit është po ashtu një proces i cili si i tillë zhvillohet nëpër faza të caktuara, si: Faza e kërkimit (hulumtimi) - në këtë fazë bëhet vlerësimi i sistemi komercial të tregtarit (fuqi/dobësi) dhe varësisht nga madhësia, lokacioni i kompanisë, vendoset për angazhime të mëtejshme, trajtimin e informatave tjera, si: të dhënat mbi organizimin dhe strukturën e kompanisë, informacionet për mallin, metodat e pagesës, vlerën e mallit, shpenzimet e dërgimit të mallit, regjistrimet, libër mbajtja etj.

Kontaktimi me importuesin: për një auditim rutinor të përmbushjes, dogana kontakton entitetin që të kërkojë informacione e nevojshme, sikur: faturat komerciale, të dhëna mbi transportin, urdhër pagesa, dërgesat, regjistra kontrata etj.

Pas kontaktimit me entitetin, caktohet takimi i parë në mes të ekipit të auditimit dhe përfaqësuesit të kompanisë, ku gjatë takimit diskutohen për qëllimin dhe objektivat e auditimit si dhe caktohet personi përgjegjës i kompanisë i cili do të bashkëpunon me ekipin e auditimit, si do të pranon kërkesat dhe ofron dokumentacion e kërkuar nga ekipi gjatë kohës së auditimit. Ekipi mund të kërkon nga kompania të plotësojë një pyetësor për të marrë informacione të nevojshme lidhur me çështjen që është objekt i auditimit që është duke u zhvilluar. Auditori duhet të mbajë plotësisht të informuar të audituarin për çdo gjetje potenciale gjatë auditimit, si dhe për çdo shkelje ekipi i auditimit koordinon punën me njësitet tjera të zbatimit të ligjit dhe vendos nëse do të fillojnë hetimet për çështje të caktuara.

Kyoto Convention, General Annex Guidelines, Chapter 6, Customs Control, World Trade Organization, December 2010

Gjithmonë pas përfundimit të auditimit, mbahet takimi përfundimtar dhe përgatitet një raport i auditimit, ku diskutohen për të gjeturat dhe rekomandimet dhe një kopje e raportit të auditimit i mbetet për kompaninë. Njësi i auditimit nga administrata doganore, mund të kryen edhe auditime nga zyra, për tu siguruar se të gjeturat dhe rekomandimet janë duke u zbatuar nga kompania e audituar.

Qëllimi e njëjtë për kontrollin pas dokumentar e gjejmë edhe tek **Blueprints for customs**, ku thotë se; zhvillimi i shërbimit të kontrollit dhe auditimit efektiv post dokumentar i lejon administratën doganore të implementoj detyrat e veta (zhdoganimin dhe kontrollin e mallrave, arkëtimin e të hyrave) dhe lehtësimin e tregtisë duke mbajtur ekuilibër ndërmjet lehtësimit të tregtisë dhe kontrollit efektiv doganor. Po ashtu edhe praktikisht brenda Doganës së Kosovës funksionon organi i caktuar që kryen kontrolle pas zhdoganimit.

Blueprints për Doganat, për të zhvilluar kontrollin pas zhdoganimit, ka parashtruar edhe disa objektiva strategjike, të cilat njëkohësisht shërbejnë edhe si kritere që duhet të përmirësohen nga vendet që kalojnë nëpër reformat dhe modernizimin e doganave të tyre, si:

Zhvillimi i bazave ligjore gjithëpërfshirëse e cila u jep zyrtareve doganor kompetencat e domosdoshme për të kryer kontrollet e pas zhdoganimit në mënyrë të mjaftueshme dhe efektive. Ne kuadrin të bazës ligjore parasheh t'i përfshinë kompetencat dhe përgjegjësitë ligjore të vendosen për kontrollin doganor si dhe obligimet dhe te drejtat e tregtarit.

Kompetenca dhe përgjegjësitë ligjore për kontroll doganore, si ne vazhdim: Kompetenca të duhura për të ushtruar kontrolle në import, eksport dhe transaksione të tjera që i takojnë autoriteteve doganore; Inspektimet dhe kontrollet e ndonjë shënim, librave, dokumenteve dhe shënimeve komerciale, duke përfshirë edhe ato që mbahen në kompjuter; Hyrja, vizita, inspektimi dhe kontrolli i ndonjë vendi që varet nga mbikëqyrja doganore; Ekzaminimi i mallrave dhe mostrave të domosdoshme; Përgjegjësia për mbajtjen e gjithë informacionit dhe dokumenteve për operatorët ekonomik privat dhe në mirëbesim.

Obligimi dhe të drejtat e tregtuesve duke përfshirë si në vazhdim: Mbajtjen e shënimeve për një kohë të caktuar ashtu si thuhet në rregullativ. Paraqitja e gjithë dokumentacionit mbështetës dhe librave komerciale dhe shënimeve (duke përfshirë versionin elektronik) për auditorët doganor; E drejta e mirëbesimit për gjithë informacionin e ofruar për autoritetet; Legjislacioni i cili mundëson sanksione efektive dhe dënime në mënyrë që të luftohet mashtrimi; Marrëveshje/ konventa të domosdoshme të ratifikuara për të siguruar bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet agjencioneve dhe shkëmbim të informacionit duke përfshirë asistencën administrative reciproke.

Po ashtu bazuar në **kapitullin 6, të marrëveshjes së Kyoto, standardi 6.10**. Ne këtë rast pasi që teksti është më i gjatë kemi bërë një kombinim në mes citimit dhe parafrazimit të dokumentit, të këtij standardi (burimi original kapitulli 6, i marrëveshjes së Kyotos), ku thuhet: Kontrollin e sistemi komercial të tregtarit që bënë dogana është me qëllim që të sigurohet mbi aktivitetin që kryen kompania, nëse aktivitetin tregtar është duke u kryer si duhet. Duke pasur parasysh që sistemi komercial ndihmohet nga përdorimi i sistemi kompjuterik, atëherë auditorë kontrollojnë edhe sistemin kompjuterik të kompanisë për të gjetur informacionet e kërkuar. Gjatë kontrolli të bazuar në auditim, auditorët ndjekin disa hapa për të kryer auditimin, si: planifikimin, mbledhjen e informatave, regjistrimi në sistem, vlerësimin, testimin, raportimin deri tek përfundimi dhe zhvillimi i auditimit. Pra edhe marrëveshja përcaktohen standardin për kontrollin e dokumenteve komerciale të tregtari sikur e pamë më lart e përcaktuar nga blueprint, po ashtu ne vijim do ta paraqesim edhe bazën ligjore në Kosovë ku jep mundësi për kontrollin pas zhdoganimit te tregtarit dhe mundësinë për kontrollin e dokumenteve tregtare, për mbledhjen e informacioneve dhe trajtimin e tyre, afatin për ruajtjen e dokumentacionit dhe informative, të drejtën për të hyrë në objektet e tregtarit për të ushtruar kontroll, si: (Kodi doganor dhe i Akcizës së Kosovës, Neni 82), *citohet*: Dogana sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të deklaruesit e rishqyrton deklaratën pas lirimit të mallit. Dogana, pasi ta ketë lejuar lirin e mallrave dhe me qëllim që të sigurohet për të dhënat e vërteta të deklaruara, në deklaratën doganore, mund të kontrollojë dokumentet tregtare dhe të dhënat që kanë të bëjnë me importin apo eksportin, si dhe veprimet pasuese (të mëvonshme) tregtare që kanë të bëjnë me këto mallra. Ky kontroll mund të kryhet në ambientet e deklaruesit ose të çdo personi, drejtpërdrejt ose tërthorazi të përfshirë në veprimet e mësipërme për arsye të veprimtarisë së tij ose të çdo personi tjetër në posedimin e të cilit janë dokumentet e lartshënuara për qëllime tregtie. Dogana, po ashtu mund të kontrollojë edhe mallrat kur paraqitja e tyre është ende e mundur. Pa rënë ndesh me nenin 219.3 kur nga rishqyrtimi i deklaratës ose kontrollit pas zhdoganimit gjen se dispozitat që rregullojnë procedurën doganore përkatëse janë zbatuar në bazën e të dhënave jo të sakta apo jo të plota, Dogana, në përputhje me dispozitat në fuqi, do të ndërmer masat e duhura për të rregulluar situatën e krijuar, duke i marrë parasysh edhe informatat e reja që janë në dispozicion.

Prandaj deri në periudhë 3 vite prapa dogana mund të ushtron kontroll tek kompania e caktuar, kjo duke ju referuar nenit 219 në kodit doganor të Kosovës ku thotë që: komunikimi i shumës së borxhit doganor nuk mund t'i bëhet debitorit pas kalimit të afatit prej tre viteve, nga data në të cilin lind borxhi doganor. Kjo periudhë ndërpritet me ushtrimin e ankesës, sipas Nenit 292, si dhe për tërë kohën e zhvillimit të procedurës ankimore.

Dogana ka të drejt të kërkojë çdo informatë nga çdo person i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë

ose të tërthortë në veprimtarinë e tregtisë së mallrave, duhet t'ia paraqet Doganës të gjitha dokumentet e kërkuara dhe të dhënat e nevojshme, pavarësisht nga mënyra e mbajtjes së tyre, si dhe të jep tërë ndihmën e nevojshme të kërkuar prej tyre dhe brenda çfarëdo afati kohor të përcaktuar, mbledhjen e këtyre informatave i mundësohet me ligj, respektivisht sipas nenit 20 të KDAK-së. Po ashtu nga kodi doganor i Kosovës, i jepet e drejta zyrtarit doganor të marri mostra, këtë të drejtë ligjore i jep neni 265, ku ofron të drejtën për marrje të mostrave të mallrave doganore me qëllim të verifikimit dhe kontrollit. Gjithashtu zyrtari doganor ka të drejtë të hyjë edhe në objekt afarist dhe verifikimi i gjendjes fizike të mallit, dhe marrjen e informative të nevojshme.

Sektori i Kontrolles Pas-Importuese – është organ i caktuar brenda doganes qe kryen kontrolla pas zhdoganimit.

Nga Kapitulli 6 ne Marrëveshjen Kyotos, kemi përshkruar edhe pjesën operative, me qëllim që të krahasojmë me praktikën që kryhet nga kontrolli pas importues nga Dogana e Kosovës, dhe në vijim paraqesim, përshkrimin e fazave të auditimit / punës operative në mënyrën të parafrazuar siç jepen nga standardet 6.6. dhe 6.10, si:

Planifikimi konsideron fazë kritike pasi që nga kjo fazë përcaktohet suksesin dhe kredibilitetin i një auditimi, këtu përcaktohet drejtimi, qëllimi, objektiva, shtrirja e kontrollit, zonat e rrezikut, takime me përfaqësuesit e kompanisë, kohëzgjatja e auditimit, burimet e nevojshme për të kryer auditimin, caktimi i personave kyç për të intervistuar etj.

Mbledhja e informatave bëhet me qëllim sigurohet se si funksionin sistemi, atë e bëjnë duke intervistuar personelin e nivelit të ndryshëm në zingjirin menaxherial, po ashtu i referohen dokumenteve të caktuar, pasta testimin e sistemi nëse është duke punuar ashtu siç është projektuar.

Regjistrimi i konstatimeve, duke i paraqitur në formë të shkruar, përmes diagrameve apo formave tjera. Vlerësimi i provave të mbledhura bëhet për të zbuluar nëse ka dobësi në sistem, po ashtu mund të bëhen teste për të matur efektivitetin e kontrollit. Testimi përdoret nëpër faza të ndryshme të auditimit për të saktësinë e informatave. Raporti paraqiten të gjitha të gjeturat, rekomandimet, çështjet që duhet ndryshuar, sugjerimet për eliminimin e dobësive në sistem, për të qenë më efektiv. Konkluzionet pas regjistrimit, vlerësimit, rekomandimeve për përmirësim, kontrollohen nëse janë duke u zbatuar rekomandimet, apo sistemi i vendosur vazhdon të administrohet dhe respektohet. Zhvillimi i auditimit, në rastet ku informatat e fituara shërbejnë për të auditime tjera apo për çështje tjera që kërkohen informata për kompaninë e caktuar.

Pasi në këtë punim bëjmë shqyrtime në drejtimin e kontrollit doganor bazuar në auditim, atëherë në këtë rast kemi shqyrtuar edhe literaturën e auditimi, revizionit dhe kontrolli pas zhdoganimit të paraqitur konceptet dhe pikat kyçe që pastaj të kemi me lehtë krahasueshmërinë e tyre, si në vijim:

Koncepti i përgjithshëm teorik mbi auditimin, kontrollin dhe revizionin

Koncepti teorik sipas Prof. dr. Vjollca Karapici: Auditimi është një proces sistematik i grumbullimit dhe vlerësimit objektiv të fakteve në lidhje me vërtetimin mbi veprimet dhe ngjarjet ekonomike për të siguruar shkallen e korrespondencës midis vërtetimeve dhe kritereve të përcaktuara dhe komunikimit të rezultateve për përdoruesit e interesuar. Përkufizimi përmban disa ide të rëndësishme, si: Auditimi është proces sistematik. Auditimi është proces logjik i logjikshëm dhe i qëllimshëm dhe bazohet në disiplinën e një metode të strukturuar për vendimmarrje. Auditimi nuk është një proces i pa planifikuar, i pa strukturuar dhe i rastit.

Procesi i auditimit angazhon grumbullimin dhe vlerësimin e fakteve. Faktet janë ato që udhëzojnë vendimet e audituesve dhe kanë lidhje me vërtetimet e veprimeve dhe ngjarjeve ekonomike. Qëllimi për grumbullimin dhe vlerësimin e fakteve është të përcaktohet shkalla e lidhjes midis vërtetimit dhe kritereve të vendosura. Audituesi në fund komunikon gjetjet. Kontrolli ka për qëllim të zbuloj gabimet dhe dobësitë me qëllim që të korrigjoj dhe të parandaloj përsëritjen e tyre. Kontrolli ofron siguri të arsyeshme, jo siguri absolute. Për të kryer një kontroll efektiv duhet të bazohemi në tri kritere:

Të jete i përshtatshëm në vendin e duhur dhe në konformitet me rrezikun përkatës; Të funksionojnë në mënyrë të qëndrueshme, pra të ketë koherencë me parashikimin gjatë gjithë periudhës; Të jetë me kosto efektive (kostoja nuk duhet t'i tejkalojë përfitimet). Nuk ekziston një sistem i përkryer i kontrollit, për shkak se ka kufizime dhe që janë natyrisht të pa kontrollueshme. Një prej objektivave dhe metodave të kontrollit është plotësimi i kërkesave sipas legjisllacionit përkatës.

Materialiteti në auditim – kur kemi materialitet në kontroll do të thotë që çështja është e rëndësishme dhe anasjelltas, nëse gjendja nuk është material atëherë mund të themi se nuk është e rëndësishme. Nuk ka rregulla strikte për atë që ndajnë materialitetin prej jo materialitetit, por përafërsisht theksohet se çdo gjë me pak se 5% mund të konsiderohet jo materiale dhe mbi 10% ka të ngjarë të jetë materiale. Por gjithmonë përveç faktorit sasior duhet pasur parasysh edhe faktorin cilësor. Rreziku në auditim – gjatë auditimit paraqiten rreziqe të cilat mund të paraqiten në tri elemente themelore, si: rreziku i qenësishëm, rreziku i kontrollit dhe rreziku i zbulimit, për ata arsyeje standardet e auditimit kërkojnë audituesi të ofron siguri të arsyeshme për zbulimin e gabimeve dhe mashtrimeve materiale.

Kampioni (paraqitja) në auditim - GAAS përcakton se kampionimi për qëllim auditimi është aplikimi i procedurave se auditimit në më pak se 100% të elementeve në popullatë. Me anë të kampionëve zvogëlohet koha dhe kostoja e auditimit. Kampionimi rrit efikasitetin. Hapat për një kampionim në auditim janë: a). Specifikimi i objektivave të auditimit, b). Përcaktimi i popullatës, c). zgjedhja e metodave të kampionimit, e). zgjedhja e kampionit, f). përcaktimi i madhësisë së kampionit, i). kryerja e testimit të procedurave të pavarura, g). vlerësimi i fakteve.

Koncepti mbi kontrollin, sipas **Shefket Jakupi dhe Hydajet Shehu**: Kontroll do të thotë mbikëqyrje, verifikimin e ngjarjes, ekzaminimin, saktësim apo konstatimin të ndonjë gjendje. Vet fjala kontroll rrjedh nga gjuha frange controle që ka të ngjarë që rrjedh nga latinishtja contra rotula me të cilën në shekullin XVIII është emërtuar kopjimi i ndonjë kontrate, vendimi, aktgjykimi. Në kuptimin gjuhësor fjala kontroll ka dy përdorime apo kuptime të cilat janë:

Përdorimi i kësaj fjale sipas kuptimit të parë: kjo fjalë ka kuptimin e “kontrolloj situatën”, “mbaj nën kontroll situatën”, “zotëroj auditorin”, “vendos rregulla dhe disiplinë etj. në mënyrë që veprimet të rrjedhin sipas parashikimeve.

Përdorimi i kësaj fjale sipas kuptimit të dytë: kjo fjalë përdoret si proces që lidhet me kontrollin dhe verifikimin e veprimtarisë financiare, që nënkupton “ekzaminim”, “cheking”, “kontrollim”, “verifikim”, “konstatim” etj.

Njëkohësisht në kuptimin më të gjerë fjala kontroll ka domethënien e mbikëqyrjes, verifikimit, apo saktësisht të ndonjë ngjarje. Pra me kontroll bëjmë hetimin e ndonjë gjendje, duke bërë krahasimin e të dhënave. Kurkemi hetuar dhe krahasuar diçka atëherë mund të gjykojmë për rregulluesin e tij.

Fjala auditing rrjedh nga latinishtja (të dëgjosh); kuptimi i saj lidhet, kryesisht me epoka shume të largët, lidhur me dëgjimin dhe gjykimin.

Sipas UNCTAD dhe OBD, Kontrolli pas zhdoganimit do të thotë “Auditim i bazuar në kontrollin doganor i cili kryhet pas zhdoganimit të mallrave nga dogana, respektivisht pas lirit të mallit në qarkullim të lirë. Qëllimi i këtij kontrolli është për të verifikuar saktësinë dhe vërtetësinë e deklaratave, përfshirë këtu edhe analizat e të dhënave të tregtarit, sistemi komercial, shënimet dhe librat tregtare.

Kontrolli pas zhdoganimit jep përfitime nga të dy anët si për doganë ashtu edhe për komunitetin tregtar. Përfitime që ka në dogana nga PCA, janë sepse ndihmojnë në mbrojtjen e hyrjeve, respektivisht mbrojtjen prej shmangies nga detyrimet doganore, zbulojnë dhe parandalon mashtrime, rrit efikasitetin e kontrollit doganor mbi tregtarin. Kurse për komuniteti tregtar PCA, përshpejton zhdoganimin e mallrave ne kufi duke zvogëluar pritjet e gjata nëpër kufij, porte, aeroporte ose në terminalët e brendshme doganore.

Instrumenti përkatës i WCO (Organizatës Botërore Doganore) përfshirë konventën e Rishikuar të Kyotos, Kornizat, Standardet, modelin doganor e të dhënave paraqet konceptin mbi Auditimin pas zhdoganimit dhe menaxhimin e riskut, ku ky dokument thotë:

Menaxhimi i rrezikut përkufizohet si” Shans të ndodh diçka që do të ketë ndikim në objektivat”. Menaxhimi i riskut bënë përpjekje për të kontrolluar dhe menaxhuar rrezikun në mënyrë për të arritur rezultatet më të mira të mundshme; ajo mund të aplikohet për të gati në çdo situatë të vendim-marrjes. Në kuadër të doganave, menaxhimi i riskut paraqet një vend modern, efektiv dhe e rëndësishme ndihmon administratën doganore për menaxhimin e funksioneve të tyre. Njëkohësisht mundëson të kryhet më pak kontrole tek kompanitë të cilat punojnë me pajtim me ligjin, rregulloret dhe standardet.

Deri sa **për Auditimin Pas Zhdoganimit, thotë:** Administratat doganore gjithashtu mbështeten në auditimin pas zhdoganimit (ndonjëherë të njohur si Post-facto). Ajo që e dallon kontrollin pas zhdoganimit me kontrollin në rastin e zhdoganimit është fakti se kjo kryhet në ambientet e operatorit që kanë zhvilluar operacionet tregtare të jashtme, dhe përfshin në thellësi shqyrtimin e të dhënave të tyre të nivelit të dytë dhe të kontabilitetit. Kjo kontroll është një mjet efektiv për optimizimin e kontrollit doganore dhe përshpejtimin e zhdoganimit të mallrave ne kufi. Auditimet pas zhdoganimit në përgjithësi janë kryer për qëllim të verifikimit të pajtueshmërisë në fushat, si: vlerësimin të mallit, origjinës, klasifikimit tarifore, procedurat e lirim nga detyrimet doganore/ rimbursim etj. Por edhe fushat tjera mund të jenë në shënjestër sipas nevojës. Varësisht nga profili i biznesit, auditimi mund të kryhet në mënyrë të vazhdueshme, ciklike ose sipas rastit. Auditimi pas zhdoganimit është mjet efektiv për kontrollin doganor për shkak se ajo siguron fotografi të qartë dhe të plotë të transaksioneve relevante që operatori i ka realizuar në doganë, respektivisht të pasqyruara në librat dhe regjistrat e tregtarëve ndërkombëtar. Në të njëjtën kohë i mundëson administratës doganore të ofroj masat e lehtësisht tregtar në formë të procedurave të thjeshtëzuara.

Organizata Boterore Doganore - Volumi 1- sipas volumit nr.1, nga OBD- përmbajnë objektivat e PCA-se (Post Clearance Audit) apo Kontrolli Pas Zhdoganimit, përfitimet që rrjedhin nga PCA, mbështetjet në korniza ligjore, kompetencat dhe përgjegjësitë e zyrtarit (auditorit), që realizon kontrollin pas zhdoganimit, detyrimet dhe te drejtat e subjektit të audituar, pastaj përzgjedhjen për auditim, nevojat për trajnim e stafit për të kryer auditim. Krijimin e marrëdhënieve me organizatat tjera doganore, menaxhimin e riskut etj.

Krahas kontroleve ne piken kufitare – doganore ka lindur edhe një lloj i një kontrole tjetër- kontroll në brendësi, e cila kontrollon subjektet për periudhën retroaktive. Kjo lindi pasi që nëse kontrollet në piken e zhdoganimit kur janë të gjata mund të jenë edhe kundër produktive, njëkohësisht subjektet mund te jete sistem kompleks të biznesit dhe zingjirin e furnizimit, dhe dokumente për të zhdoganuar mallin janë të kufizuara në kontekst me dokumentet e një transaksionit tregtar ndërkombëtarë, i cili është i nevojshëm për të përcaktuar vlerën doganore, kodin tarifor, origjinën preferenciale etj. Prandaj dogana përqendrohet në kontrollin pas importit përderisa bëjnë kontrollet efektive dhe shenjëstrohet në kufi. Kontrolli pas zhdoganimit aplikon qasje të bazuar në rrezik.

Post Clearance audit (kontrolli pas zhdoganimit) – përkufizohet si një shqyrtim i strukturuar te: biznesi, sistemeve përkatëse tregtare, kontratat e shitjes, të dhënave financiare dhe jo financiare, tregtarëve fizik dhe kontrole të tjera për të përmirësuar përmbushjen. Një program dinamik i menaxhimit te riskut është i domosdoshëm për PCA.

Objektivat e PCA -se: për tu siguruar që deklaratat doganore janë përfunduar sipas kërkesës doganore, janë paguar taksat për mallin, sigurohet për certifikatat e kërkuara të mallit, kuotat, ndalimet, kufizimet si dhe për lehtësimin e lëvizjeve ndërkombëtarë. PCA dallohet nga auditimi i brendshëm që e ka dogana.

Përfitimet nga PCA: mund të reduktohen kontrollet në kufi, rreziku identifikohet, vlerësohet dhe trajtohet më lehtë.

Llojet e verifikimeve nga Kontrolli pas Zhdoganimit (Post Clearance Audit - PCA) ; janë:

Auditimi i tavolinës

Auditimi në terren

Auditimit i zyrës – mund të zhvillohet me telefon dike i kërkuar informata subjektiviteti të caktuar. Kjo nuk është plotësisht në terren, por rëndësia është se përfaqësuesi i subjektivitetit e kupton se vëzhgohet aktiviteti i tij nga dogana. Pas kësaj nëse është e nevojshme merret veprimet për auditim në terren në ambientet e subjektivitetit.

Kornizat ligjore dhe operative për Kontrollin pas Zhdoganimit – Për të lehtësuar Kontrollin pas Zhdoganimit është e nevojshme për të zbatuar legjisllacionin të përcaktuar nga dogana; legjisllacioni vendor apo rajonal nëse bëhet fjalë për bashkim doganor. Me legjisllacion përcaktohen të drejtat, detyrimet, përgjegjësit, kompetencat si të auditorit po ashtu edhe të audituarit. Me legjisllacion duhet të përcaktohet edhe skema e dënimeve, të drejtat e ankimit, pastaj subjektivitetet që duhet të kontrollohen, që potencialisht këto subjektivitetet mund të jene të gjitha të përfshira në: import, eksport, deklaruesi, transportuesi, agjenti doganor, përfituesit e atij malli dhe të gjitha bizneset tjera që qoftë në mënyrë direkte apo indirekte janë të përfshira në transaksionet e importuesit të mallit.

Planifikimi strategjik për Kontrollin Pas Zhdoganimit – pasi në një vend, administrata doganore vendoset sistemi e Kontrollit Pas Zhdoganimit, atëherë hapi tjetër vijues, duhet të zhvillohet një plan i auditimit, ku në kuadër të këtij plani do të përcaktohen numri i kontroleve, natyra e auditimit që do të kryhet zakonisht për një vit, i cili ky plan duhet të jetë në përputhje me kornizën kombëtare të kontrollit.

Përzgjedhja për auditimi: zakonisht përzgjedhjen për auditim e kryen ekipi i dedikuar i analizës se riskut, pastaj caktohet ekipi i Kontrollit Pas Zhdoganimit për të kryer auditimin, dhe po ashtu informatat që dalin nga auditimin të kthehet tek analiza e riskut për subjektivitetet e caktuar.

Promovimi i përputhshmërisë së përmirësuar me anë të vetë-vlerësimit: ofron këshilla për tregtarët për të inkurajuar përmbushjen. Disa administrata ofrojnë edhe vendime paraprake për çështjen e klasifikimit tarifor, origjinës, vlerësimin për të siguruar importuesin para arritjes së mallit. Kontrollit Pas Zhdoganimit jep rekomandime për procesin e aktivitetit të biznesit. Importuesit / deklaruesit mund t'ju jepet mundësia që të bëjnë ndryshime të deklaratave doganore, ku ato kanë vërejtur gabimet që nuk është në përputhje me ligjin, pa dënim, apo pa hyrë në Kontrollin Pas Zhdoganimit në kontroll tek këto biznese. Kontrollit Pas Zhdoganimit do të duhet të përmirësoj nivelin e bashkëpunimit.

Menaxhimi i burimeve: Me ngritjen e zyrtareve të Kontrollit Pas Zhdoganimit behet edhe rialokimi i stafit, nga stafi në kufi të zyrat e PCA-se duke pasur parasysh zvogëlimin e kontroleve në kufi dhe rritjen në brendësi të territorit të vendit.

Trajnimi për zyrtarët e Kontrollit Pas Zhdoganimit ses: zyrtarët duhet të kenë njohuri apo trajnime për fushën e teknikave të kontabilitetit, parimeve të kontabilitetit dhe auditimit, njohja e ligjeve doganore, njohuri mbi sistemin e kontabilitetit të bazuar në sistemin kompjuterik, njohurit mbi strategjinë e biznesit ndërkombëtar, si dhe aftësitë teknike në fushën e klasifikimit tarifor, origjinës së mallit, vlerësimit si dhe taksave dhe tatimeve. Po ashtu ky kuadër duhet të përkrahët edhe me njerëz me aftësi të specializuara.

Etika e auditimit: auditori përveç standardeve të larta profesionale duhet të ketë edhe: integritet, të mbaj konfidencialitet, kompetenca profesionale, si dhe mbaj kriterin e paanshmërisë. Pra është e njohur se PCA apo kontrolli pas zhdoganimit është mjeti me efektiv për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat doganore. Veçanërisht në fushën e vlerësimit doganor, verifikimin e të dhënave të importuesit përmes sistemit të kontabilitetit, i cili ky zhdoganim nuk është i mundur me rastin e zhdoganimit të mallit. Prandaj administrata doganore duhet vazhdimisht të përpiqet për të zbatuar kontrollin pas zhdoganimit në masën sa me të madhe të mundur. Por në vendet me nivel të lart të ekonomisë informale, Kontrolli pas zhdoganimit nuk është mjet shume praktik deri sa në ato vende mund të mos gjinden bizneset, nuk ka sistem të strukturuar të kontabilitetit, andaj mënyra me e mirë tek këto vende prapë mbetet kontrolli më i shtuar në kufi.

Menaxhimi i riskut: menaxhimi i riskut i mundëson doganës që të kryej përgjegjësitë në mënyrë efektive dhe të vendos burimet në mënyrë që të përmirëson performancën e përgjithshme dhe lehtëson tregtinë. Menaxhimi i riskut bene detyrat e tyre sipas procesit si: vendosja e kontekstit, vlerësimi i riskut, analiza e riskut, vlerësimi i prioriteteve, trajtimi, regjistrimi, komunikimi dhe konsultimi, monitorimi dhe ri-shikimi i ndihmon kontrollin pas zhdoganimit në planifikimi për auditimin në vijim. Bashkëpunimi (ndërlidhja) me sektorët tjerë brenda vendit dhe ndërkombëtare: Kontrolli pas zhdoganimit nuk funksionon e pavarur, por është në funksion të organizatës i lidhur mirë me organet të tjera përkatëse. Për të përshkruar funksionin e varësisë, paraqesim shembullin, nëse gjatë auditimit paraqitet dyshim për mashtrim, kontrolli pas zhdoganimit, konsultohet me hetimet, për t'ia kaluar rastin hetimeve ose kërkon ndonjë interpretim të caktuar ligjor, kërkon këshill ligjore apo gjatë dialogut me importuesin ka mosmarrëveshje, kërkon ri-shqyrtim të vendimit. Pastaj duhet të ketë bashkëpunim (ndërlidhje) me departamente e taksave. Po ashtu shumë i rëndësishëm është bashkëpunimi me administrata tjera doganore për qëllim shkëmbimi të informatave (të dhënave) që do të ndihmojnë dhe lehtësojnë kryerjen e një auditimit me efektiv.

Kontrolli pas-impores / Udhërrëfyes, referencë dhe implementues, sipas vëllimit II nga OBD

Metodologjia themelore e KPZH bazohet në kërkimin bashkohor dhe analizën e faktorëve të cilat kontribuojnë në krijimin e një mjedisi me përqindje të lart të përmbushjes dhe njëkohësisht lehtëson transaksione ndërkombëtare. KPZH është në funksion edhe në zhdoganimin e mallrave para- arritjes, kjo duke ofruar informatat e më hershme, lidhur me subjektivitetin apo mallin e caktuar. KPZH fokusohet në sistemin e biznesit me qëllim të rritjes së nivelit të përmbushjes (përmirëson përmbushjen).

KPZH – përveç përmirësimit të nivelit të përmbushjes konfirmon edhe zonat potenciale të rrezikut, ku mund të ketë nevojë për përmbushje shtese apo zbatim të ligjit. Njëkohësisht KPZH mund të identifikon edhe subjekte me përmbushje të lart të cilat do të duhet të klasifikohen me rrezik të ulët. Deri sa jemi tek koncepti i KPZH duhet bërë dallimi në mes KPZH dhe Hetimit, pasi të dyja kanë shumë pika të përbashkëta, sepse kryen aktivitetin pothuajse të ngjashëm, mirëpo deri sa dallohet në pikën që KPZH kërkon përmirësimin e përmbushjes, kurse hetimet ndjekjen penale për mashtrimin e caktuar që realizon një biznes. Në një rast kur konsiderohet një transaksion me rrezik të lart, atëherë duhet të merren menjëherë masat e verifikimit, kontrollit, duke mos pritur një auditim pas zhdoganimit.

Aspektet kyç të KPZH: pritet që auditori të mos ketë qasje tradicionale, si: ligjin doganor, aftësitë teknike tarifore, vlerën dhe origjinën, por dhe aftësitë mbi kontrollin e sistemit tregtar, pasi që KPZH është e dizajnuar për të rishikuar sistemin e tyre biznesor, kontrollin e brendshëm, të vlerësoj efektin e masave të tyre të përmbushjes dhe bërjen e rekomandimeve mbi përforcimet ose ndryshimet që do të ndikojnë për të arritur përmirësimin e përmbushjes në të ardhmen. Prandaj KPZH duhet të kryhet një shkallë të lart profesionalizmi duke u bazuar në SNA – Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit që janë relevante, parashohin:

Përgjegjësinë e auditoreve dhe menaxhereve të auditimit. Planifikimin e auditimit dhe mbledhjen e informatave; Identifikimin e kontroleve të brendshme dhe vlerësimin e rrezikut të tregtarit; Testimet audituese dhe mbledhjen e mjaftueshme të fakteve audituese për të formuar një opinion mbi nivelin e përmbushjes së tregtarit; Shfrytëzimin e punës së auditorëve tjerë dhe vlerësimin e rrezeve; Rezultati i auditimit, raporti i auditimit, komunikimi mbi tregtarin dhe menaxhmentit e agjencionit.

Edhe auditori i KPZH -se mund të shfrytëzoj punën e auditorëve të tjerë vetëm se duhet të testoj ngjarjet herë pas here. KPZH mund të shfrytëzoj edhe ekspertin e fushave të ndryshme gjatë auditimit, p.sh me kimi, DPI etj.

Raporti i auditimit duhet të jetë: relevant ndaj atyre që shfrytëzojnë këtë raport, i besueshëm apo i bazuar në prova, i afte për të identifikuar dhe diskutuar çështjet të rëndësishme, i nxjerr në kohën e duhur, të jetë i kuptueshëm nga lexuesi si dhe në përputhje për të lejuar krahasim (SNA 700).

Metodologjia

Në këtë punim kemi përdorur krahasimin e aspektit ligjor dhe praktikave që përdoren për të realizuar kontrole doganore pas zhdoganimit të mallit. Gjatë shqyrtimit dhe krahasimit të dokumenteve, aspektit ligjor dhe praktikave, në njërin anë kemi vendosur Marrëveshjen e Kyotos - Kapitullin 6 respektivisht standardet 6.6 dhe 6.10 në shqyrtim, pastaj një prej objektivave të Bluesprint për Doganat siç është kuadri legjislativ, pastaj Volumin 1 për kontroll pas zhdoganimit, Post clearance audit i përgatitur nga Banka Botërore ku paraqet praktika e punës së kontrollit pas zhdoganimit, si dhe koncepte dhe metodat e ushtrimit të një auditimit të marrë nga literatura, pra të gjithë këto që i përmendim qëndrojnë në një anë kurse në anë tjetër aspekti ligjor dhe praktikave të punës së kontrollit pas importuese nga Dogana e Kosovës, dhe në këtë mënyrë kemi krahasuar dhe ka rezultuar me një nivel të lart të harmonizimit dhe përputhshmërisë.

Konkluzionet

Nga krahasimi që i kemi bërë në mes standardit 6.6 dhe 6.10, ku përmes këtyre standardeve sipas marrëveshjes së Kyotos, në kapitullin nr.6, thuhet se kontrolli doganor të bëhet në bazë të auditimit, pastaj krahasimit të disa pikave për kontrollin pas dokumentare në Blueprints për Doganën që shërben njëkohësisht si një udhëzues praktike për modernizimin e doganave këto dy dokumente kemi krahasuar me legjislacionin që përcakton dhe praktikave që zbatohen për kontrole pas zhdoganimit, kemi arritur në përfundim që kemi harmonizime të plote tek pikat, si:

Sikur që parashihet sipas standardeve 6.6 që kontrolli doganor të bëhet në bazë të auditimit, edhe kodi doganor dhe i akcizës së Kosovës, jep mundësinë e kontrollit pas zhdoganimit, të të gjithë personave dhe kompanive që janë lidhur direkt apo indirekt me importin, eksportin, tranzitin, deri në tri vite pas të kryhet një akt zhdoganimit.

Sikur që parashihet sipas standardit 6.10, që të kontrollohet sistemi komercial (të gjithë dokumentacioni i kompanisë), po ashtu i njëjti sugjerim është gjetur edhe tek Blueprints për Doganën, po ashtu edhe sipas KDAK-se në nenet e caktuara të cekura me lart i jepet e drejte zyrtarit të kontrollit nga Dogana e Kosovës, të kontrolloj të gjithë dokumentacionin e nevojshëm tregtar, dhe dokumentacionet tjera që mund të sjellin deri të informata e vlerëshme, si dhe të kërkojnë dhe marrin çdo informate dhe të gjitha veprimet e nevojshme për kryer verifikimit e plote të çështjes së caktuar, e cila këto veprime që ndërmerren konsiderohen veprime auditimi.

I shërben qëllimit për lehtësimin e qarkullimit më të shpejt në kufi, ku vazhdimisht shkon duke u zvogëluar numri i kontroleve në kufi.

Gjatë kontrollit doganor pas zhdoganimit, kryesisht fokusohet në verifikimin e vlerës doganore të mallit, origjinës së mallrave, klasifikimit tarifor, klauzolave tregtare - kushteve të dërgesës, pagesave të detyrimeve.

Kontrollet i realizon në bazë të analizës së rrezikut dhe planit të auditimit, ashtu siç sugjerohet nga dokumentet të lartcekura ndërkombëtare.

Jep rekomandimet për kompanitë për të përmirësuar respektimin e legjislacionit dhe procedurave.

Bibliografia

World Customs Organization, Kyoto Convention, General Annex Guidelines, Chapter 6, Customs Control, World Trade Organization, December 2010;

Kodi doganor dhe i Akcizës së Kosovës, 03/L-109 (i ndryshuar me 04/L-099),
Udhëzimi Administrativ 11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizës 03/L-109

Blueprints for customs, 2010

WCO Guidelines for Post-Clearance Audit, Volumi 1

Post Clearance Audit: Reference and Implementation Guide, The World Bank 2011

Kalpic, Vjollca, Auditimi, botimi, Tiranë 2011

SMALL GOVERNMENT OR BIG GOVERNMENT?

DR.MATEO SPAHO

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti Ekonomik, Financë-Bankë

ABSTRACT

Since the beginning of the twentieth century, economists and philosophers were polarized on their positions beyond the role that the government should have in the economy.

On one hand John Maynard Keynes represented, within the optics of market economy, a position where the state should intervene in the economy to maintain the aggregate demand and the employment in the country, without hesitation in creating budget deficits and public debt expansion. This approach happens especially in the moments when the domestic economy and global economic trends show a weak growth or a recession. This means a heavy interference in the economy, with higher income but with high expenditure to GDP too. On the other side, Liberals and Neoliberals led by Friedrich Hayek advocated a withdrawal of the government from economic activity not just in moments of economic growth but also during the crisis, believing that the market has self-regulating mechanisms within itself. The government, as a result will have a smaller dimension with lower income and also low expenditures compared to the GDP of the country.

We took the South-Eastern Europe countries distinguishing those with a “Big Government” or countries with “Small Government”. There are analyzed the economic performances during the global crisis (2007-2014). In which countries the public debt grew less? Which country managed to attract more investments and which were the countries that preserved the purchasing power of their consumers?

We shall see if during the economic crisis in Eastern Europe the Great Government or the Liberal and “Small” one has been the most successful the model.

Fjalë kyç: *Liberal state, Crisis, Eastern Europe, Economic growth, Big Government*

1. Introduction

John Maynard Keynes has been the principal actor that built the Keynesian economics. His view was focused in the short run. Especially during recessions, economic output is strongly influenced by aggregate demand (total spending in the economy). In the Keynesian view, aggregate demand does not necessarily equal the productive capacity of the economy. Instead, it is influenced by a host of factors and sometimes behaves erratically, affecting production, employment, and inflation.

The theories forming the basis of Keynesian economics were first presented into *The General Theory of Employment, Interest and Money*, published in 1936, during the Great Depression. Keynes contrasted his approach to the aggregate supply-focused 'classical' economics that preceded his book. The interpretations of Keynes that followed are contentious and several schools of economic thought claim his legacy. Keynesian economists often argue that private sector decisions sometimes lead to inefficient macroeconomic outcomes which require active policy responses by the public sector, in particular, monetary policy actions by the central bank and fiscal policy actions by the government [1], in order to stabilize output over the business cycle. Keynesian economics advocates a mixed economy that allows private sector, but with a role for a strong government intervention, especially during recessions.

He saw the economy as unable to maintain itself at full employment and believed that it was necessary for the government to step in and put under-utilized savings to work through government spending. Thus, according to Keynesian theory, some individually rational microeconomic-level actions such as not investing savings in the goods and services produced by the economy, if taken collectively by a large proportion of individuals and firms, can lead to outcomes where in the economy operates below its potential output and growth rate.

Keynes argued that the solution to the Great Depression was to stimulate the economy ("inducement to invest") through some combination of two approaches:

- A reduction in interest rates (monetary policy), and
- Government investment in infrastructure (fiscal policy).

By reducing the interest rate at which the central bank lends money to commercial banks, the government sends a signal to commercial banks that they should do the same for their customers.

In this situation the Government Budget was almost the half of the entire GDP of a country.

Keynesian economics served as the standard economic model in the developed nations during the latter part of the Great Depression, World War II, and the post-war economic expansion (1945–1973). After 1973, at the same time Unemployment and Inflation were raising up, causing a stagflation undermining the Keynesian and macroeconomic theories.

On the other hand, building on the earlier work of Ludwig von Mises, Friedrich Von Hayek also argued that while in centrally planned economies an individual or a select group of individuals must determine the distribution of resources, these planners will never have enough information to carry out this allocation reliably. This argument, first proposed by Max Weber, says that the efficient exchange and use of resources can be maintained only through the price mechanism in free markets.

Hayek theories were followed by Margaret Thatcher and Ronald Reagan. Politically speaking these policies were known as Reaganomics [2] and were applied during 1981-1989.

The pillars of his economic vision were:

- Reduction of the public debt growth
- Reducing taxes on labor and capital income
- Reduction of regulation on business (deregulation)
- Control of the money supply and inflation reduction

This policy reduced the government role on the economy allowing a bigger level of freedom for the business. The government budget in this case was reduced to 30% of GDP. A reason for adopting minimal government interference in the economy is for its beneficial consequences in GDP, Inflation, Unemployment and not for any ideological reason. At the heart of economic neoliberalism are various theories that prove the economic neoliberal ideology [3].

The advent of the global financial crisis in 2008 has caused a resurgence in Keynesian thought, encouraging the government role to resolve or to lessen the impact of the global crisis [4]. For many countries, this meant an increase of public expenditure, through unemployment benefits and through an increase of the size of the state in the economy. In parallel with the increase in public spending was allowed an increase in taxation and thus prevented the economic growth. Other countries preferred not to raise taxes but to increase the deficit and consequently the public debt. This led to the sovereign debt crises especially on the European continent.

What about the Balkans during the last global economic crisis? Does the Balkans countries have a big dimension of the state budget compared with the national economies or do they follow neoliberal economic theories?

Which are the countries that were affected to a lesser extent by the global crisis and whom managed to protect the purchasing power of their citizens? Are they countries that have followed the Keynesian theories that grew mostly during the crisis? In which country, as required, public debt and became problematic? At the end, this paper aims to highlight if during the last global crisis, were the countries that followed neoliberal policies those who faced the crisis better or if the increased size of the state and the government, according to the Keynesian doctrines, helped to overcome the economic crisis.

2. Methods

The data examined belong to eight years an axis of time, from 2007 to 2014. In that line we can see the situation of the countries of the South Eastern Europe before the beginning of the Global Crisis and their evolution over the years. The countries surveyed are ten: Albania, Kosovo, Bosnia, Montenegro, Macedonia, Serbia, Croatia, Bulgaria, Romania and Hungary. Were taken yearly data on total revenues and expenditures of the countries analyzed a total of 160 data. This was done to distinguish the states in countries with governments or Neoliberal Keynesians. Later in the year we analyzed the evolution of public debt by noting an annual average the countries that have done most to increase their sovereign debt. Finally, we have highlighted the total investment of the total economy. Thus you can see in countries such investment and therefore economic growth was higher. There is not necessary to implement econometric analysis in this case. Through Excel program we can made calculations that shows concrete results on the behavior of countries. In the Balkan and South European and we highlighted the main macroeconomic and indicators on the lens of the Keynesian and Neoliberal doctrines.

3. Results

In the table above we can see the revenue budgets of the states analyzed. As you can notice the countries can be divided into two groups. The groups are distinguishable because follow the theories of Hayek and more generally those neoliberals. These are the countries that have a tax burden below 35% of GDP. These countries are Albania, Kosovo, Macedonia, Bulgaria and Romania. On the other hand countries like Bosnia, Croatia, Hungary, Montenegro and Serbia have a great status or income tax exceeds 40% of GDP. This means that the fees are usually higher than those of most "Neoliberal" countries but also the expenditures will be higher. The smallest Governments in Revenues are the Albanian and the Kosovo one. The biggest tax revenues are collected in Montenegro and Bosnia. In the table 2, below, we can see that the biggest government expenditures occur in Serbia, Hungary and Bosnia, on the opposite side there is Kosovo government. During the crisis years, no country changed its own believes about the government dimension compared to the economy. The Keynesian countries (white stripes) carried on taxing and spending to support the economy instead the Neoliberal countries (yellow stripes) continued to promote a contained role of testate in the economy.

TABLE 1: COUNTRIES TAX REVENUES

Country Revenues	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Albania	26.1	27.3	26.6	26.4	25.8	25.1	24.1	26.1
Bosnia	46.7	45.5	44.9	46.8	45.9	46.3	45.1	45.1
Bulgaria	38.2	38.0	35.3	32.7	32.4	34.0	35.5	36.3
Croatia	39.8	39.2	39.0	38.2	37.4	38.6	38.1	40.1
Hungary	45.6	45.5	46.9	45.6	54.3	46.9	47.7	48.3
Kosovo	25.9	24.3	28.0	26.4	27.1	26.1	24.6	24.7
Macedonia	32.7	33.1	31.2	30.3	29.7	30.0	29.5	31.4
Montenegro	49.2	48.4	42.5	41.3	38.5	40.1	41.3	42.6
Rumania	32.3	32.2	31.2	32.2	32.6	32.9	31.8	33.1
Serbia	44.0	42.8	42.2	42.5	40.6	42.1	40.6	41.1

Source: World Bank Database

TABLE 2 COUNTRIES GOVERNMENT EXPENDITURES

Gov. Expenditures	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Albania	29.2	32.3	34.3	30.6	29.4	28.6	29.3	32.8
Bosnia	47.1	49.7	49.6	50.3	48.8	48.9	47.0	49.2
Bulgaria	34.9	35.2	36.2	36.7	34.4	34.4	37.4	39.0
Croatia	40.8	40.1	42.2	42.7	42.0	41.9	43.5	44.8
Hungary	50.6	49.2	51.4	49.9	50.0	48.9	50.0	51.2
Kosovo	18.9	24.5	28.9	28.7	28.9	28.7	27.8	26.9
Macedonia	32.1	34.0	33.9	32.7	32.2	33.8	33.6	34.8
Montenegro	42.9	51.6	47.8	45.9	43.8	45.9	44.6	44.1
Rumania	35.4	37.0	38.5	38.6	36.8	35.4	34.3	35.3
Serbia	44.9	44.8	46.0	46.4	45.0	49.4	46.3	50.0

Source: World Bank Database

In the table 3 we can see the course of the public debt of the countries has been outlined. At this point already it may be noted that the Public Debt to GDP ratio on Neoliberal countries (Albania, Bulgaria, Kosovo, Macedonia and Romania) grew on average by 2.8% per year. In the countries with high Revenues and Expenditures (Bosnia, Croatia, Hungary, Montenegro and Serbia) the Public Debt to GDP growth ratio was 4.4% on average.

This increase in public debt by countries interventionist economy was predictable because the increasing public expenditure cannot be filled by an increase in taxation. In fact, in countries with high tax revenues a further tax increase would lead to an extreme economic slowdown and social unrest. Consequently governments that adopted a Keynesian approach have no other alternatives to debt.

TABLE 3: SOVEREIGN DEBT

Sovereign Debt	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	Average
Albania	53.4	56.1	60.8	58.8	60.4	62.9	70.5	72.1	2.7
Bosnia	18.7	30.9	35.8	39.1	40.8	44.6	42.5	46.1	2.5
Bulgaria	18.6	15.5	15.6	14.9	15.4	17.5	16.4	25.2	1.6
Croatia	32.9	29.3	35.8	42.6	47.4	54.2	60.2	66.3	6.2
Hungary	67.0	73.0	79.8	82.1	82.1	79.8	79.3	79.1	1.0
Kosovo									
Macedonia	23.0	20.9	24.1	24.5	27.9	33.4	35.9	36.3	2.6
Montenegro	27.5	29.0	38.2	40.9	46.0	54.0	58.0	60.3	5.2
Rumania	12.7	13.6	23.8	31.1	34.3	38.2	39.4	39.9	4.4
Serbia	34.6	33.4	38.1	46.5	49.5	62.4	65.8	75.6	7.0

Source: World Bank Database

Looking at each country, we can see that despite many experts warned and proposed extreme measures to control the public debt in Albania, from 2007 to 2014 the increase in Sovereign Debt was 18.7% of GDP. It might seem very much but out of nine countries analyzed, Albania was one of those who less increased its public debt.

Serbia was the country most affected by an increase in public debt which grew by 41% of GDP from 2007 to 2014. The following country was Croatia which increased the debt by 33.4% of GDP and Montenegro with 32.8%. All together the three countries have a large state with high taxes and to even more high expenditures.

If we can say that the increase of expenditures may cause the increase in debt, on the other hand is normal to think that the excess spending is spent in investments by the government. You can expect consequently that countries with a larger public expenditure have higher levels of investment in their economies. We must not forget, however, that the government investments are a minority part of the total investment, led by entrepreneurs, which tends not to invest in the presence of a high tax burden. Again you can see that the countries that followed Neoliberal economic policies had the largest total investments. Albania had the highest percentage of total investment to GDP in a virtuous competition between state, domestic investors and foreign investors. The following countries are Bulgaria and Romania, both with low income and low expenditures.

The countries with the lowest percentage of Investments are Bosnia and Hungary. On average Neoliberal countries during the period 2007-2014 had a percentage of the Investments on GDP of 26.8% while Keynesian countries have only 22% of GDP made by Investments. Purchasing Power Parity rate is useful to understand an average of the being of population, through a given amount of one currency thus has the same purchasing power whether used directly to purchase a market basket of goods or used to convert at the PPP rate to the other currency and then purchase the market basket using that currency. Observed deviations of the exchange rate from purchasing power parity are measured by deviations of the real exchange rate from its PPP value of 1. PPP exchange rates help to minimize misleading international comparisons that can arise with the use of market exchange rates. For example, suppose that two countries produce the same physical amounts of goods as each other in each of two different years. Since market exchange rates fluctuate substantially, when the GDP of one country measured in its own currency is converted to the other country's currency using market exchange rates, one country might be inferred to have higher real GDP than the other country in one year but lower in the other; both of these inferences would fail to reflect the reality of their relative levels of production.

TABLE 4: TOTAL INVESTMENTS RATIO TO GROSS DOMESTIC PRODUCT

Investments/GDP %	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	Average
Albania	30.6	33.5	30.5	26.9	25.8	24.3	22.9	24.9	27.4
Bosnia	24.5	26.1	18.6	15.6	18.1	18.1	18.2	19.8	19.9
Bulgaria	34.1	37.5	29.4	22.9	21.9	21.7	20.9	23.5	26.5
Croatia	29.9	31.3	25.9	21.9	21.5	20.5	20.4	19.1	23.8
Hungary	22.4	23.5	18.0	19.3	19.2	17.5	17.6	18.8	19.5
Kosovo									
Macedonia									
Montenegro	33.8	40.7	27.1	22.8	19.5	19.5	15.9	19.6	24.9
Rumania	31.0	31.3	25.4	25.6	26.8	26.0	22.9	22.5	26.4
Serbia	29.0	29.7	18.0	17.2	20.1	21.1	18.5	20.7	21.8

Source: World Bank Database

FIGURE 1: ALBANIAN TOTAL INVESTMENTS COMPARED WITH THE MAXIMAL AND MINIMAL INVESTMENTS IN THE REGION




TABLE 5: PURCHASING POWER PARITY PER CAPITA IN INTERNATIONAL USD

Purchasing Power Parity	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Albania	7622	8436	8872	9388	9900	10291	10596	11055
Bosnia	8186	8825	8666	8862	9147	9214	9563	9808
Bulgaria	13707	14907	14278	14623	15568	16039	16518	17115
Croatia	20398	21241	19948	19793	20196	20109	20222	20392
Hungary	21667	22336	21012	21529	22381	22525	23236	24336
Kosovo								
Macedonia	10312	11016	10976	11406	11938	12079	12587	13204
Montenegro	12580	13687	12977	13435	14129	13990	14666	15219
Rumania	14875	16308	15374	15410	16142	16560	17440	19397
Serbia	10687	11361	11090	11384	11855	11982	12465	12605

Source: World Bank Database

In the table 6 we can see that the countries with a small government are those who on average have allowed their citizens to increase their welfare. Albania is the country that guides this ranking for two reasons. The first is a definite development of the country which has continued, albeit at lower rates, despite the economic crisis. The second reason is that the population of the country has decreased, increasing the purchasing power per person with 45% during the period 2007-2014.

TABLE 6: CUMULATIVE PERCENTAGE GROWTH IN PURCHASING POWER PARITY

2007-2014	Growth in %
Albania	45.0
Bosnia	19.8
Bulgaria	24.9
Croatia	0.0
Hungary	12.3
Kosovo	
Macedonia	28.0
Montenegro	21.0
Romania	30.4
Serbia	18.0

Romania and Macedonia, both Neoliberal countries follows the Albanian exploit while welfarist and Keynesians countries, that through the Government intervention would support the economy are those who obtained poor results in the defense of the purchasing power of their citizens.

The differences here are also visible in the averages. Countries with a large Government increased the purchasing power per person by 14.2% over the last eight years while the countries that followed the theories related to the Reaganomics increased the purchasing power by 32.1% per person.

The table 7 shows the sum and the product of all the upper indicators. In fact, the small governments, which have left in the pockets of their citizens the money via low tax, had an economic growth much higher than those who thought that the

government could make better use of public money than they could do themselves. The Neoliberal group (Albania, Bulgaria, Kosovo, Macedonia and Romania) had an average year growth of GDP by 2.7% instead the Keynesian group (Bosnia, Croatia, Hungary, Montenegro and Serbia) had an average year growth of GDP by 0.9%.


TABLE 7: GDP GROWTH IN %.

Country	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	Average
Albania	5.9	7.5	3.4	3.5	2.3	1.1	0.4	2.1	3.3
Bosnia	6.0	5.6	-2.7	0.8	1.0	-1.2	2.1	0.7	1.5
Bulgaria	6.4	6.2	-5.5	0.4	1.8	0.6	0.9	1.4	1.5
Croatia	5.1	2.1	-6.9	-2.3	-0.2	-2.2	-0.9	-0.8	-0.8
Hungary	0.1	0.9	-6.8	1.1	1.6	-1.7	1.1	2.8	-0.1
Kosovo	8.3	4.5	3.6	3.3	4.4	2.8	3.4	2.7	4.1
Macedonia	6.1	5.0	-0.9	2.9	2.8	-0.4	2.9	3.4	2.7
Montenegro	10.7	6.9	-5.7	2.5	3.2	-2.5	3.5	2.3	2.6
Rumania	6.3	7.3	-6.6	-1.1	2.3	0.6	3.5	2.4	1.8
Serbia	5.4	3.8	-3.5	1.0	1.6	-1.5	2.5	-0.5	1.1

Source: World Bank Database

Albania, in this indicator too, for many years managed to stay close to the maximum levels of economic growth in the South Eastern Europe until 2011 where the economic crisis and the slowdown of credit begun to damage the country's economic growth.

FIGURE 2 ALBANIAN GDP GROWTH COMPARED WITH THE MAXIMAL AND MINIMAL GDP GROWTH IN THE REGION.



Till now economists believed that during periods of economic crisis, following the Keynesian policies, governments should increase their expenditures by resorting to deficit spending and consecutive increases of the public debt.

All this would be justifiable if governments would increase spending to support aggregate demand and consumption. That would increase the GDP and improve the relationship between public debt and GDP. This theory, however, was elaborated only in emergencies, such as economic crises.

Usually governments should be of small size relative to GDP. What we did not expect by the results of analysis of Southeastern Europe is that during the economic crisis too it's better to follow the Neoliberal doctrines, intending with that a state with little income and contained expenditure. During the economic crisis too, the Neoliberal countries grew more than the Keynesians and welfare countries. With Neoliberals countries we mean: Albania, Kosovo, Macedonia, Bulgaria and Romania. With Keynesians countries we mean: Bosnia, Croatia, Hungary, Montenegro and Serbia.

During the period 2007-2014, when the crisis hit Europe, the Neoliberals Balkans countries have increased their public debt to GDP by 2.8% per year. Countries with a large government increased their public debt to GDP by 4.4% per year.

Total investment on GDP in countries with a large government were 22% on average, while countries with a small government had on average 26.8% of GDP per year on investments. The purchasing power of citizens in the Neoliberal countries is arising by an average of 32.1% cumulatively from 2007 to 2014, while in the same period in Keynesians countries purchasing power per person is arising by only 14.2%.

Finally, GDP at constant prices in countries with small Governments is ascending by an average of 2.7% per year over the time period analyzed, while in countries with a Government of large scale, economic growth has barely reached 0.9% per year.

4. Conclusions

Is evident that, the Neoliberal Governments works better than the Keynesian ones, whom intervene in the economy not only during periods of economic growth but also during economic crises. This does not happen only in developed countries but also for developing countries as the Southeastern European countries are. Governments need to recognize that citizens know

how to administer their money better than the Government Institutions. The Governments must reduce taxes and public spending. Big Governments, in this case, were not able to support the economy, consumption and investment, but have only been able to squander taxpayers' money.

References

- Baxendale A, Toby M:** The Battle of the Letters: Keynes v Hayek 1932, Skidelsky v Besley 2010". The Cobden Centre. Retrieved 14 September 2011.
- Fletcher A, Gordon F:** The Keynesian Revolution and Its Critics: Issues of Theory and Policy for the Monetary Production Economy. Palgrave MacMillan. pp. xix–xxi, 88, 189–191, 234–238, 256–261. ISBN 0-312-45260-8 Braedley S. and Luxton M., Neoliberalism and Everyday Life, McGill-Queen's University Press, 2010, ISBN 0773536922, 3.
- Brittan S, Oxford Dictionary of National Biography, Oxford University Press, 2004.**
- Farrell H. and Quiggin J:** "Consensus, Dissensus and Economic Ideas: The Rise and Fall of Keynesianism During the Economic Crisis". The Center for the Study of Development Strategies. Retrieved 2012-05-29.
- 0-312-45260-8 Braedley S. and Luxton M.:** Neoliberalism and Everyday Life, McGill-Queen's University Press, 2010, ISBN 0773536922, 3.
- Hayek FA:** The Constitution of Liberty, London: Routledge & Kegan Paul, 1960.
- Keynes J M:** "The Theory of Money and the Foreign Exchanges". A Tract on Monetary Reform (1924)
- Markwell A, Donald L:** John Maynard Keynes and International Relations: Economic Paths to War and Peace. New York: Oxford University Press. ISBN 0-19-829236-8.
- Palley Th I:** From Keynesianism to Neoliberalism: Shifting Paradigms in Economics. Foreign Policy in Focus. May 5, 2004; Retrieved November 11, 2014.
- Taylor CB, Jordan GM:** Neoliberalism: From New Liberal Philosophy to Anti-Liberal Slogan. In Studies in Comparative International Development. June 2009, 44(2): 137–161
- World Bank database - October 2014

Bibliografia

- Abiad, A., Dell'Ariccia, G., & Bin L. (2011). Creditless Recoveries, IMF Working Paper 11/58, Washington, March 2011.
- Banka e Shqipërisë (2011). Rregullorë "Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja", f.8-12.
- Banka e Shqipërisë (2013). Raporti i Mbikëqyrjes Bankare 2013, f.14.
- Çeliku, E. (2014). Shitja e huave (me probleme) – një mekanizëm që krijon vlerë të shtuar për bankën, Revista BANKIERI (AAB), nr.14. f.39-40, janar 2015.
- Đoković. N. (2013). Zgjidhja e çështjes së huave me probleme në Mal të Zi, Revista BANKIERI (AAB), nr.9, f.19-21, tetor 2013.
- Goldstein, M. & Weatherstone, D. (2001). Implications of Early Warning Models of Crisis, aper prepared for KDIC International Financial Symposium on «The Financial Crisis and Beyond», Seoul, Korea, December 11, 2001.
- IMF (2014). ALBANIA - Financial System Stability Assessment, IMF Country Report No. 14/79, March 2014.
- Impavido, G., Klingen, C.A. & Sun, Y. (2012). Non-Performing Loans and the Macroeconomy (2012). Chapter 2 of Working Group on NPLs in Central, Eastern and Southeastern Europe, March 2012.
- Murgasova, Z., Ilahi, N., Miniane, J., Scott, A., Vladkova-Hollar, I. (2015). The Western Balkans - 15 Years of Economic Transition, Regional Economic Issues - Special Report, IMF, March 2015.
- Nadège, J., & Kang. K. (2015). A Strategy for Developing a Market for Nonperforming Loans in Italy, IMF Working Paper, WP/15/24.
- Nazaj, S. & Meka, E. (2014). Loan management and its *ex ante* & *ex post* role in the lending proces, Journal of Academic Research in Economics, Vol.6, Nr.3, November 2014.
- Polo, A. (2012). Ndryshimet në legjislacionin tatimor fiskal dhe ndikimi i tyre në aktivitetin dhe eficiencën bankare, Revista BANKIERI (AAB), nr.5. f.13-15, tetor 2012.
- Stijepović, R. (2014). Recovery and Reduction of Non-Performing Loans – Podgorica Approach, Journal of Central Banking Theory and Practice, 2014, 3, pp. 101-118, 25 July 2014.
- World Bank (2013). South East Europe Regular Economic Report No.5, December 2013, p.18.
- Ziu, G. (2014). Platforma e Bankës së Shqipërisë për trajtimin e huave me probleme – një qasje e re, Revista BANKIERI (AAB), nr.10. f.14-15, janar 2014.
- Burime nga interneti:**
www.bankofalbania.org
www.imf.org
<http://www.worldbank.org>
 Kuvendi i Shqipërisë (2013). "Për projektligjin "për një shtesë në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, "për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar", http://www.parlament.al/web/pub/kom_ligjeve_raporti_per_tatimin_mbi_te_ardhurat_16349_1_16497_1.pdf)

ZHVILLIMI I SISTEMIT INFORMATIV GJEOGRAFIK GIS DHE IMPAKTI I TIJ NË ZBULIMIN E BOTËS

MSC. AFËRDITA ÇEKAJ- THAÇI

PHD candidate, Profesor në Kolegjin Universitar "Pjetër Budi", Prishtinë

aferdita.cekaj-thaqi@kosovopoliice.com; aferdita06@gmail.com

ABSTRAKT

Qëllimi kryesor i këtij punimi hulumtues është të shpjegojë thelbin e GIS si dhe fazat e hershme të zhvillimit të tij deri tek përdorimi tij në shumë fusha duke mundësuar dhe lehtësuar operimet në masë të madhe. Zhvillimi i hershëm i GIS-it kishte filluar shekuj më parë duke u paraqitur në formë vizuale në formë të hartave kartografike në fillimet e shekullin e 19. Zhvillimi i GIS filloi në laboratorët kërkimor në mënyrë që të ndihmojë planifikuesit dhe vendimmarrësit e politikave urbane që të kenë një vizualizim të qartë të hartave duke u avancuar në zhvillim deri në krijimin e grafikëve 3D të cilat gjejnë vend në përdorim në ditët e sotme. Zhvillimi i GIS-it kishte evoluar shumë shpejt. Rëndësia dhe funksionaliteti i këtij sistemi kishte bërë që studiuesit, ekspertë dhe analistë kishin filluar së zbatuari GIS-n në shumë lëmi dhe në shumë shtete të botës. Ky zhvillim i GIS ndikuar ndryshimet transformuese në shumë vende të botës, duke përfshirë modele ekonomike, sociale dhe politike. Kohëve të fundit GIS ka gjetur një rol të rëndësishëm në formulimin strategjik të qeverisë në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e jetës për qytetarët, shoqërinë dhe mjedisin. Shumë hulumtime janë bërë kohët e fundit në mënyrë që të stimulohen dhe të ndihmojnë kërkuesit për përdorim të GIS-it duke përdorur funksionalitetin e këtij sistemi për të përshtatur atë në përmbushjen e nevojave dhe kërkesave hulumtuese. Nevojat dhe kërkesat për përdorim të GIS-it janë të përqendruara edhe në nevojat qeveritare, organizatave të ndryshme por edhe ato individuale duke asistuar në zgjidhjen e shumë problemeve hapësinore. Përmbushja e nevojave dhe kërkesave shihet se janë të arritshme më lehtë duke kombinuar avancimet e teknologjisë dhe në mënyrë të veçantë aplikimit të sistemit GIS.

Fjalë kyç: GIS, sistemi, funksionalitet, ekonomik, social, politik.

1. Hyrje

Sistemi Gjeografik Informativ është një sistem i projektuar i të dhënave. Sistemi mbledhë, analizon, proceson dhe menaxhon të gjitha llojet e të dhënave gjeografike. Ky sistem i informacionit është një sistem në zhvillim e sipër që ka gjetur përdorim në shumë vende në botë. Rëndësia dhe aplikimi i GIS-it është në menaxhimin e bizneseve, planifikimeve hapësinore, atë të transportit, logjistikës dhe shumë lëmi e veprimtari të tjera. Bazuar në hulumtimin, qeveria e SHBA-së ishte e para që zbatoi teknologjinë GIS pasi që zbatimi i këtij sistemi ishte dëshmuar se sjell shumë përfitime. Nga 1984 - 1997, qeveria amerikane miratoi aplikimin e GIS në më shumë se 80% të administratës. Origjina e hershme e GIS-it i atribuohet Roger Tomlison-it i cili njihet si shpikës i sistemit të informacionit gjeografik. Në atë kohë, Tomlison një profesor i inxhinierisë civile dhe planifikimit kishte zhvilluar softwar-in në bashkëpunim me disa shoqata të të njëjtës fushë inxhinierike. (Drummond, William J., dhe Steven P. French).


Përfitimet që mund të nxirren nga GIS-i me fokus në zgjidhjen e problemeve dhe analizave hapësinore, shumë shkencëtarë u mblodhën për të diskutuar dhe filluan të bëjnë kërkime në përmirësimin e mjedisit falë përdorimit të GIS-it. Rezultati bëri që shumë ekspertë të fushave të ndryshme që mblidhen rreth GIS, kontribuuan në botimin e një reviste e cila u quajt Gazeta e Sistemeve gjeografike. Kjo revistë, e cila përmban 16 artikuj të shkurtër kishte ngritur diskutime në masa globale në atë si të përdorej sistemi GIS dhe funksionalitetet e tij për të përmirësuar shumë gjëra të rëndësishme në të gjithë botën (Getis, Arthur). Avancimet dhe aplikimet e GIS-it mundësojnë zgjidhjet e shumë problemeve, të aplikuarit e tij vërejmë se mund të gjejë vend edhe në Republikën e Kosovës, si një vend në zhvillim e sipër i cili mund të bëjë shumë këtë drejtim. Arsyeya kryesore është sepse fokusi kryesor për vendet si Kosova është që të zhvillohet ekonomikisht përmes krijimit të sistemeve të informacionit. Bazuar në Reibel dhe Michael, avancimet GIS kanë rritur disponueshmërinë e të dhënave dhe së fundi, në botën moderne ne të gjithë jemi përballur ose merremi me GIS-in nëse ne jemi në punë, në shtëpi, pushime, kudo. Arsyeya pse ne bëjmë atë është sepse ne përdorim harta për gjithçka, madje edhe për orientimin (REIBEL, Michael). Duke parë mundësitë bazuar në evoluimin e teknologjisë informative dhe përdorimin e saj në shumë vende të botës, të aplikuar e sistemit të GIS në Kosovë shihet se është një domosdoshmëri pasi që përpos përdorimit të tij nga qeveritë, organizatat e ndryshme, bizneset, laboratorët kërkimore vërehet se GIS dukshëm ndihmon në përmirësimin e jetës së qytetarëve, mbi të gjitha.

2. Çfarë është GIS?

Fillimisht do të ishte mirë të sqaronim çfarë është GIS-i (Sistemi Informativ Gjeografik). GIS është sistem hardware, software, i të dhënave, njerëzve, organizatave dhe institucioneve që shërben për mbledhjen, ruajtjen, analizimin dhe paraqitjen e informatave gjeografike (Elangovan, 2006). Në zemrën e çdo sistemi GIS është baza e të dhënave. Sistemi i bazës së të dhënave ofron lehtësira duke mundësuar që të dhënat e mbledhura të jenë të vendosura në formën e duhur. Të dhënat janë të vlefshme (këtu flasim për vlerat e informatave) kur ato të jenë pjesë e strukturës së marrëdhënieve të cilat formojnë përmbajtjen e të dhënave. Përderisa shumë nga aplikacionet mund të kërkojnë modele të thjeshta të të dhënave, GIS kërkon aplikacione me modele të të dhënave më komplekse, GIS kërkon që të sigurohen shumë të dhëna të cilat i konverton në informata. Të dhënat për GIS-in sigurohen nga imazhet satelitore, hartat, GPS, të dhënat e hulumtimeve dhe instrumente të tjera. Kur projekti i GIS-it njëherë të jetë i krijuar, mundësitë e përdorimit të tij janë shumë të mëdha dhe të përmasave të gjëra (Worboys, 2003).

3. Funksionaliteti i GIS-it

FIGURA 1. MODELI I GIS



Burimi: GIS A computing Perspective

GIS është sistem shumë funksional dhe i përsosur i cili asiston në kryerjen e shumë punëve të mëdha dhe komplekse dhe të cilat njëkohësisht kërkojnë angazhime. Funksionaliteti i GIS-it bazohet në shumë elemente duke u paraqitur si “Forma e GIS” (shih figurën 1). Elementet si pjesë funksionale përbërëse të GIS janë:

Elementi i bazës së të dhënave:

Në zemrën e çdo sistemi GIS është baza e të dhënave e cila është një koleksion e të dhënave e organizuar në atë formë që kompjuteri mund të vendos dhe tërheq ato të dhëna në mënyrë efishiente.

Elementi i Procesimit të të dhënave:

Modelet e të dhënave janë hapa të mëtutjeshëm drejt manipulimit dhe procesimit të të dhënave. Softveri i GIS-it duhet të ketë funksionalitet të mjaftueshëm për të siguruar analiza të cilësisë apo klasit të lartë.

Elementi mbledhjes dhe i rigjetjes së të dhënave:

Vendosja efishiente dhe rigjetja e të dhënave të strukturuar në bazë të të dhënave ofrojnë performancë të kënaqshme por edhe optimalizojnë strukturat, prezantimin dhe algoritmet për operim të të dhënave të GIS-it.

Elementi ndarjes së të dhënave:

GIS përbëhet nga shumë komponent softwer dhe hardwer të tilla si serverët e të dhënave gjeografike, kërkuesit në internet si dhe pajisjet mobile kompjuterike. Këto pajisje, si shembull mund të ilustrojmë, mund të lejojnë akses në informatat e kohës reale për gjetjen e rrugës për të vozitur deri në shtëpi duke ju drejtuar me informata rreth dendësisë në trafik, punimet e mundshme në rrugë, ndryshimet e kushteve të rrugës si dhe shumë informata të ndryshme, pjesë komponente të cilat përmblidhen së bashku si informata për përdorim.

Elementi i të dhënave për prezantim:

Të dhënat brenda në sistemin GIS dhe operacionet performuese bazuar në ato të dhëna, nuk janë të vlefshme derisa ato të mos jenë të gatshme për komunikim mes njerëzve që e përdorin GIS-in. Shumë sisteme tradicionale informative kërkojnë formë të përsëritshme të prezantimit bazuar në tabelat dhe data e llogaritjes kompjuterike apo dhe komenteve tekstuale, përderisa këto forma po ashtu kërkojnë të mbështesin vendim-marrjen duke përdorur GIS-in.


Elementi i përkohshëm hapësinor:

Bota është e përkohshme dhe hapësinore. Përdorimi i sistemit GIS na mundëson të ruajmë dhe procedojmë fenomenin dinamik gjeo-hapësinor i cili ndryshon në kohë (Worboys, Duckham, 2004).

4. Pse është i vlefshëm përdorimi i GIS-it?

Fillimet e para të krijimit dhe përdorimit të hartave kartografike ishin të dedikuara dhe kishin për qëllim që të përdreshin për të shënuar vende të cilat shërbenin si komunikim hapësinor.

FIGURA 2. EVOLUIMI I HARTAVE . ZHVILLIMI I HARTAVE FILLUAR NGA KARTOGRAFITË DERI NË HARTAT DIGJITALE.



Burimi: Benjamin D. Hennig,

Më vonë ato kanë evoluar ndër shekuj duke u përshtatur për nevojat e ndryshme të kohës. Ndërsa në ditët e sotme falë teknologjisë informative ne kemi mundësi të krijojmë harta dhe modelojmë ato përpos komunikimit hapësinor, edhe për shumë qëllime të tjera përdorimi i të cilave ka gjetur vend në shumë lëmi.

Për të krijuar databazën e GIS është një punë apo proces i cili merr kohë. Avantazhet e punës dhe procesit të zgjidhur në krijim të aplikacionit vërehen shpejt pasi njëherë të jetë i krijuar sistemi GIS, rezultatet e ofruara janë shumë të aplikueshme dhe të përdorshme. Të dhënat nga GIS mund të nxirren vetëm me një klik nga monitori i kompjuterit, laptopit apo pajisjeve të tjera të avancuara elektronike. Vlerësimet dhe dëshmia e bazuar në funksionalitetin dhe lehtësimin e zgjidhjeve që mundëson GIS-i duke gërrshetur këtu edhe zhvillimet teknologjike, përdorimi i tij ka filluar të gjej hapësira të mëdha në shumë fusha tjera jetësore (Elangovan, 2006).

“Rediscovering the world-Map transformations of Human and Physical Space”

6. Zhvillimi i GIS-it dhe zbatimi i tij në kontest botëror

Shumica e njerëzve sot e konsiderojnë sistemin GIS si teknologji sfiduese. Në fakt, GIS-i përfaqëson një brez të rëndësishëm të sistemeve të cilat ndihmojnë, si teknologjitë e vjetra tradicionale po ashtu edhe teknologjitë e reja të komunikimit të sistemeve të informacionit. Në fillimet e përdorimit të sistemit përmendur edhe më lart, GIS kishte ndihmuar planifikuesit urban, qeveritë, policinë, armatën, organizatat e ndryshme po ashtu dhe politikëbërësit për të krijuar lloje të ndryshme të hartave. Në ditët e sotme me zhvillimin e teknologjisë GIS mundëson që të paraqesim modele të ndryshme në harta dhe madje edhe duke krijuar ato me vizualizimin grafik 3D (Van de Donk, Wim BHJ). Dy dekada më parë, GIS kërkonte të një sistem operativ UNIX për tu aktivizuar. Ndërsa arritjet teknologjike dhe zhvillimi i kompjuterëve personal ka lehtësuar përdorimin e GIS-it dhe ky ritëm i përdorimit të këtij sistemi shihet se përparon me shpejtësi. Në këtë pikë nuk ka munguar angazhim i ekspertëve duke bërë që GIS të zhvillohet në mënyrë të shpejtë që ne mund ta përdorim atë sot në kompjuter personal, laptop, desktop apo edhe tableta (Drummond, William J). Bazuar në disa hulumtime, Kina ka zhvilluar sistemin GIS në qytetin urban Shenzen në bashkëpunim me qeverinë. Shembull i qytetit Shenzen mund të merret si shembull i miratimit dhe zbatimit kërkimor të GIS-it. Arsyeja kryesore pse merret shembull qyteti Shenzen është sepse qeveria ka bërë shumë praktika për të aplikuar sistemin GIS në këtë vend, me qëllim që qyteti Shenzen të jetë një model për qytetet e tjera për zbatimin e GIS në vendet urbane. Përveç kësaj, zbatimi i GIS-it dhe miratimi nga agjencitë ose organizatat publike ishte model i mirë që të filloj përdorimin e tij në masë më të gjerë në shtetin Kinez. Bazuar në po të njëjtin hulumtim, GIS ka lehtësuar punën e punonjësve në organizatë edhe pse ekspertët kanë argumentuar se sistemi është shumë i ndërlikuar për ta zbatuar atë në praktikë nga punonjësit e thjeshtë. Faktorët kryesorë për zbatimin e GIS janë mbështetja e teknologjisë, burimet financiare, fleksibiliteti i organizative dhe trajnimi i punëtorëve (Wen, Lin). Lidhur me zbatimin e GIS, shumë vende të zhvilluara çuditërisht luftojnë për moszbatim të tij dhe shumica e tyre fajësojnë teknologjinë për këtë. Ky zbatim kompleks është parë në qeveritë lokale dhe rajonale. Shumica e qeverive të vendeve të zhvilluara nuk ishin të gatshëm për të marrë rrezikun e përdorimit të GIS dhe kjo është arsyeja kryesore pse ata zgjedhën që të merren me pjesën teorike të tij në vend të përdorimit praktik. Sigurisht që GIS ka nevojë për disa mjete financiare dhe angazhim/ përkushtim nga ana e personelit por duke lexuar dhe informuar se si duhet të qasemi për të krijuar një sistem të qëndrueshëm të GIS-i, mund të konkludojmë se qasja dhe implementimi i tillë nga disa qeveri në zhvillim mund të dështojë në arrijtjen e qëllimeve që ka GIS-i. Përveç kësaj, hulumtimi tregon se një zbatim i suksesshëm i GIS-it është ngushtë i lidhur me politikë-bërësit dhe zbatimin e politikave të tyre dhe kjo mund të jetë arsyeja kryesore pse njerëzit e sektorit publik kanë interpretim të ndryshëm të GIS-it me atë të punonjësve të një OJQ-je të cilët punën e tyre e zbatojnë në terren (Ramasubramanian). Zbatimi i GIS kërkon një arsimim dhe trajnim të duhur. Marrja e edukimit apo trajnimit do të thotë një angazhim dhe përgjegjësi për të menaxhuar apo operuar me sisteme GIS. Në një hulumtim të bërë na jep të kuptojmë se njerëzit fillimisht kishin refuzuar për të ndryshuar mënyrën e të punuarit të deri atëhershëm dhe kishin tendencë për të refuzuar teknologjitë e reja. Kjo është arsyeja pse shumë vende përballën me mungesa të operatorëve të GIS-it, flasim për në fund të viteve 1980 kur sistemi GIS kishte filluar të shfaqej dhe së aplikuari. Me futjen e GIS-it në përdorim njerëzit, sidomos studentët, e kishin perceptuar atë si diçka të madhe, si diçka që do të ketë një ndikim të madh në jetën tonë, duke e refuzuar atë. Megjithatë, ishte një prezantim interaktiv dhe vizual që arriti të mbajë studentët afër në mënyrë që ata të kenë më shumë njohuri dhe si përdorues më të përshtatshëm për punuar me GIS. Krijimi i hartave dhe imazhet e shpjeguara mirë kishte bërë që të tërheqin vëmendjen e tyre dhe ti bëjnë ata të jenë më të afërt dhe të kenë vullnet në përdorim të GIS-it (Peshkopin, Ian). Andaj, siç u shpjegua më lartë implementimi i GIS nuk është zbatuar nga të gjithë, por disa vende janë shumë të interesuar për zbatimin e sistemit GIS në qeveritë e tyre, shembull të cilin do të duhej ta ndiqte qeveria e Republikës së Kosovës, e cila si vend i dal nga lufta dhe në zhvillim, ka një arsye më shumë duke qenë se ka afinitet që popullata e saj e re të jetë më e përkushtuar në fushën e teknologjive të informacionit dhe komunikimit. Aplikimi i GIS-it po ashtu do të ndihmojë që vendi të përmbush kërkesat e BE-së në këtë aspekt, dhe të jetë në hap me shtetet të cilat aspiron të jetë pjesë e tyre.

7. E ardhmja e GIS në botë

Me të gjithë që është thënë më lart, mund të shtrohet pyetja ku do ta çojë GIS-i botën. Bazuar nga këndvështrimi im, e ardhmja e GIS-it mund të shkoj larg parashikimeve, duke bërë që të lehtësoj në masë të madhe jetët tona, duke na mundësuar të arrijmë të arrijmë qëllimet qofshin afatshkurta apo ato afatgjata. Argumenti i cili mbështet këtë mendim është i bazuar në faktet e dala nga shumë hulumtime të cilat mbështesin idenë se sistemi GIS do të mbizotërojë botën. Shembull për këtë mund të marrin shpikjen e kompjuterit dekada më parë, ishin dashur që shumë të bëhen ndryshime, përmirësime qoftë në softwer apo hardwer për të bërë atë shumë më të shpejtë, më të fuqishëm dhe të jetë më efektiv në kosto. Shembulli i kompjuterit mund të jetë udhërrëfyes duke dëshmuar se edhe GIS ka të njëjtin rrugëtim së bashku me internetin, komunikimin wireless, si dhe GPS-in. Së bashku me përmirësimet e tij vazhdueshme GIS do të gjejë përdorim në çështjet hapësinore si dhe do të ngrit aftësitë e planifikuesve duke e përdorur at (Klosterman, Richard). E ardhmja e GIS shihet e sigurt nga menaxherët e konstruksioneve dhe ndërtimtarisë. Ideja ishte të përdorej GIS për kërkesat dhe nevojat e ardhshme në lëmin e konstruksioneve dhe ndërtimeve. Veçanërisht analistët e tregut të pasurive të patundshmerisë janë duke e parë dhe llogaritur GIS-in si sistem informativ tejet të domosdoshëm për përmirësim të parashikimeve në të ardhmen. Andaj sot e vetmja gjë që duhet është që thjeshtë të zhvillojmë një profil për një zonë të caktuar dhe ti kemi të gjitha të dhënat e nevojshme për parashikim sa më të saktë (Smith, Charles).

Arsyeja kryesore në plotësimin e nevojave për të ardhmen është shpjeguar nga ekspertët dhe analistët të cilët përdorin GIS-i. Kjo do të thotë se GIS jo se do të përmirësoj vetëm menaxhimin e informacionit, por edhe të procedurave të vendimmarrjes në Vlerësimin Strategjik Mjedisor VSM si dhe Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor VNM. Kjo do të lejojë që ata të bëjnë kërkime në të ardhmen në mënyrë që të zhvillojnë edhe më shumë sistemin GIS dhe përdorimin e të dhënave hapësinore në çështjet e mjedisit. Me një fjalë, kërkohen që disa përpjekje shtesë të cilat shihet se janë të nevojshme në mënyrë që të jetë plotësisht i funksionalizuar dhe i zbatueshëm përdorimi i GIS-it (Campo, Ainhoa).

Nisur nga fakti se planeti po ndryshon, trendet në rritje të GIS -it paraqesin kompleksitetin, kureshtjen si dhe shumë mundësi që të zhvillojnë atë. GIS është mundësi e artë për fizicienët, matematicientët, ekologjistët, dhe shumë hulumtues nga disipinat e tjera si ato shoqërore dhe humane që të bashkëpunojnë në këtë projekt tejet të madh. Shumë njerëz janë duke bashkëpunuar me hulumtuesit andaj të njëjtit mund të shpërblehen apo mund të fitojnë çmimin Nobel për ekonomi gjeografike siç e kishte bërë Paul Krugman (Sui, Daniel). Kjo mundësi tejet e veçantë dhe e vlefshme mund të ju ndihmojë shumë ekspertëve që të ndryshojnë planetin tonë duke e bërë atë shumë më të mirë se çfarë është tani. Pos kësaj përfshirja e GIS do të duhej të gjejë vend në biznes. Aplikimi i GIS-it do të ndihmonte bizneset e pasurive të patundshme, ato të shërbimeve zingjirore, kompanitë e pajisjeve të ndryshme, dyqanet e shitjes zingjirore me pakicë si dhe kompanitë e sigurimeve.

Sistemet GIS në të ardhmen mund të jenë model dhe shembull për arritje të progresit në teknologji sepse shihet qartë se zhvillimet teknologjike nuk kanë të ndalur. Sa i përket aspektit social GIS shihet si faktor i cili në të ardhmen do të mbroj privatësinë e personave. Pra në disa raste sistemi GIS mund të përdoret për ruajtje të fshehtësive dhe privatësisë së personave. Ky është një faktor interesant në të cilin mund të llogarisim në të ardhmen për përdorimin sa më të gjërë të GIS-it nga popullata. Të vlefshme shoh se përdorimi i sistemit GIS mund të ishte ndihmues edhe në Kosovë duke ju ofruar banorëve të vendit shumë ndihmesa si në biznes, edukim, kërkime shkencore dhe përdorim në aspektin social. Mbi të gjitha përdorimi i GIS nga vendi siç është Kosova do të kontribuonte që mbi të gjitha të ruhej por në disa raste edhe të rritej niveli i sigurisë duke shfrytëzuar zhvillimet teknologjike.

8. GIS dhe shoqëria si tërësi

Përderisa bota është duke u zbuluar përmes sistemit GIS dhe pajisjeve shtesë, kjo do të thotë se ka ende vende të virgjëra në këtë planet. Pra, shoqëria ka një rol të rëndësishëm në drejtim të eksplorimit të planetit tonë. Sistemet GIS japin këtë mundësi për të eksploruar botën, mjediset dhe shoqëritë njerëzore duke e lidhur literaturën për Sistemin e Informacionit Gjeografik (Goodchild, Michael). Duke mbështetur këtë fakt, disa hulumtime tregojnë se sistemi GIS do të ketë një ndikim të madh në shoqërinë në të ardhmen. Njerëzit do të kenë qasje me te lehtë në informata që mund të përdoren për ndonjë hulumtim apo edhe gjatë kohës së punës. Ai mund të zgjidh problemet e ndryshme sociale në bazë të informacioneve dhe kërkesave në të ardhmen (Eric Sheppard). Lidhja e GIS me shoqërinë ose e ashtu-quajtur Shoqëria e Informacionit Global mund të bëjë ndryshime sociale nga lidhjet e rrjeteve telekomunikuese. Komunikimi i shpejtë përmes rrjeteve telekomunikuese, zhvillimi dhe integrimi i tyre do të krijojnë një vlerë të re sociale në aspektin nacional. Kjo do të thotë që qeveritë mund të forcojnë marrëdhëniet e tyre me vendet fqinje. Pra, GIS mund të përdoret si një mjet politik për përmirësimin dhe zgjidhjen e problemeve ekonomiko-sociale mes popujve ose shteteve. (Audenhove, Luani Van).

Duke e ditur faktin se shumë terma janë duke u bërë fjalë ndërkombëtare të tilla si globalizimi, shoqëria e informacionit, informacion global dhe ekonomia globale, kjo do të thotë se fjalori akademik është duke u pasuruar çdo ditë. Fjalori luan një rol të rëndësishëm në shoqëri duke stimuluar dhe sfiduar atë për të parë se si shoqëria reagon në ndryshime të tilla. Kjo do të thotë se informacioni, ekonomia, politika dhe jeta në përgjithësi është duke u globalizuar nga këto ndryshime. (Barrett, Michael).

Përderisa sistemi GIS është në zhvillim e sipër, një faktor kyç për të ndihmuar qeveritë të krijojnë besimin me qytetarët dhe të bëjnë përmirësime sociale dhe zgjidhje, kjo do të thotë se bota po përballet me ndryshime transformuese të tilla si globalizimi, teknologjitë moderne dhe mënyrat më të shpejta të qasjes në informata. Siç u përmend më lartë, marrëdhënia mes sistemit GIS dhe shoqërisë është shumë e rëndësishme, veçanërisht mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj. Duke e ditur faktin se Kosova është një shtet i ri i pas luftës, ajo duhet të kultivojë kulturën e besimit midis qeverisë dhe qytetarëve të saj. Unë besoj se aplikimi i sistemit GIS mund të jetë një zgjidhje shumë e mirë në drejtim të çështjeve institucionale.

9. Përfundimi

Deri në këtë pikë mund të shtrohet pyetja, nëse vërtetë sistemi GIS është duke e rizbuluar botën? Përgjigja ime është, absolutisht po. Nëse kthehemi dy dekada më parë, është e qartë se mënyra e jetesës ishte e ndryshme duke përfshirë ndryshimet socio-ekonomike dhe politike. Në botën e sotme, procesi i globalizimit dhe avancimet teknologjike bënë që GIS-i të personalizohet dhe të shfrytëzohet në bazë të nevojave dhe kërkesave të të dhënave me komponentë hapësinore. Ndikimi i GIS-it dhe kryesisht i teknologjisë dixhitale bëri që shumë studiues, ekspertë dhe analistë, institute kërkimore të mendojnë për ndikimin e tij në jetën e përditshme. Siç është cekur më lartë, shumë shembuj, teori dhe hulumtime mbështesin faktin e zhvillimit të GIS-it dhe të ardhmes së tij. Qeveritë, organizatat dhe individët u vetëdijesuan se sistemi GIS do të ndihmojë në arritjen e

qëllimeve të tyre duke lehtësuar detyrat e tyre, duke e bërë jetën shumë më të lehtë, më të shpejtë dhe qasje më të shpejtë në informata, duke përfshirë edhe pamjet vizuale dhe grafiken 3D. Ndërsa më e rëndësishmja duke ndihmuar qytetarët të kenë një standard më të mirë të jetës.

Bibliografia

- Audenhove, Leo Van, et al. "Information Society Policy In The Developing World: A Critical Assessment." *Third World Quarterly* 20.2 (1999): 387-404. Business Source Complete. Web. 15 Mar. 2015.
- Barrett, Michael, Sundeep Sahay, and Geoff Walsham. "Information Technology And Social Transformation: GIS For Forestry Management In India." *Information Society* 17.1 (2001): 5-20. Business Source Complete. Web. 15 Mar. 2015.
- Bishop, Ian D., et al. "Meeting The Need For GIS Skills In Developing Countries: The Case Of Informal Settlements." *Transactions In GIS* 6.3 (2002): 311. Business Source Complete. Web. 13 Mar. 2015.
- Bivand, R. S. (2000). Using the R statistical data analysis language on GRASS 5.0 GIS database files. *Computers & Geosciences*, 26(9), 1043-1052.
- CAMPO, AINHOA GONZÁLEZ DEL. "Gis In Environmental Assessment:: A Review Of Current Issues And Future Needs." *Journal Of Environmental Assessment Policy & Management* 14.1 (2012): 1250007-1-1250007-23. Business Source Complete. Web. 14 Mar. 2015.
- Carver, S. (2001, December). Participation and Geographical Information: a position paper. In ESF-NSF Workshop, Spoleto, Italy.
- Drummond, William J., and Steven P. French. "The Future Of GIS In Planning: Converging Technologies And Diverging Interests." *Journal Of The American Planning Association* 74.2 (2008): 161-174. Business Source Complete. Web. 13 Mar. 2015.
- Elingovan, K. (2006). "GIS: Fundamentals, Applications and Implementations". Laxmi Art Creations, New Delhi
- Getis, Arthur. "Introduction: Spatial Analysis And GIS: An Introduction." *Journal Of Geographical Systems* 2.1 (2000): 1. Business Source Complete. Web. 13 Mar. 2015.
- GIS and Society: Towards a Research Agenda, Eric Sheppard, *Cartography and Geographic Information Systems* Vol. 22, Iss. 1, 1995
- Goodchild, Michael F. "Rediscovering the World through GIS." *Prospects for a Second Age of Geographical Discovery. GISPLANET* 98 (1998).
- Hnson, S. (2001). "10 Geographic Ideas That Changed the World". Library of Congress Cataloging-in-Publication Data. US.
- Klosterman, Richard E. "Comment On Drummond And French: Another View Of The Future Of GIS." *Journal Of The American Planning Association* 74.2 (2008): 174-176. Business Source Complete. Web. 13 Mar. 2015.
- Moalla-Fetini, R., & International Monetary, F. (2005). *Kosovo: Gearing Policies Toward Growth and Development*. Washington, D.C.: International Monetary Fund.
- Norris, Janice G., and Elka Tenner. "GIS In Academic Business Libraries: The Future." *Journal Of Business & Finance Librarianship* 6.1 (2000): 23. Business Source Complete. Web. 14 Mar. 2015.
- Ramasubramanian, Laxmi. "GIS Implementation In Developing Countries: Learning From Organisational Theory And Reflective Practice." *Transactions In GIS* 3.4 (1999): 359. Business Source Complete. Web. 13 Mar. 2015.
- Reibel, Michael. "Geographic Information Systems And Spatial Data Processing In Demography: A Review." *Population Research And Policy Review* 26.5-6 (2007): 601-618. EconLit with Full Text. Web. 13 Mar. 2015.
- Smith, Charles A. "Using GIS To Improve Estimates Of Future Demand." *Journal Of Property Management* 63.4 (1998): 84. Business Source Complete. Web. 14 Mar. 2015.
- Stapleton, L. (2011). *Technology Adoption in Post-Conflict Regions: EDI Adoption in Kosovo After the War*. *Journal Of Global Information Management*, 19(3), 65-84. doi:10.4018/jgim.2011070104
- Sui, Daniel. "Opportunities And Impediments For Open GIS." *Transactions In GIS* 18.1 (2014): 1-24. Business Source Complete. Web. 14 Mar. 2015.
- Van de Donk, Wim B.H.J., and John Taylor. "Geographic Information Systems (GIS) In Public Administration: An Introduction To A Series Of Articles." *Information Infrastructure & Policy* 6.3 (2000): 127. Business Source Complete. Web. 13 Mar. 2015.
- Wen, Lin. "GIS Development In China's Urban Governance: A Case Study Of Shenzhen." *Transactions In GIS* 12.4 (2008): 493-514. Business Source Complete. Web. 13 Mar. 2015.
- Worboys, F. M. (2003). "GIS: A computing Science Perspective." *British Library Cataloguing in Publication Data*. UK.
- Worboys, M & Duckham, M. (2004). "GIS: A computing Perspective, Second Edition". *Library of Congress Cataloging-in-Publication Data*

MARRËVESHJET E TREGTISË SË LIRË DREJT LIBERALIZIMIT TË TREGTISË

ARDITA SEKNAJ

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti Ekonomik
ardita.seknaj@gmail.com

ABSTRAKT

Shqipëria tashmë prej 25 vitesh operon në një regjim të liberalizuar të tregtisë ndërkombëtare. Ndërmarrja e reformave të ndryshme tregtare përgjatë këtyre viteve, tranzicioni politik dhe ekonomik si dhe synimet drejt aderimit në BE kanë rezultuar në paraqitjen e situatave të ndryshme kthesash në mbarëvajtjen e reformave. Këto situata kanë bërë që rritja e aftësive konkurruese të sektorëve prodhues apo shërbimeve në vend të jetë akoma në tranzicion dhe gjithashtu ka reflektuar ngadalësimin herë pas here të stabilitetit makro-ekonomik në vend dhe deficit të lartë tregtar. Pavarësisht se arena ndërkombëtare dhe sidomos ajo europiane ka synuar integrimin e vendeve të rajonit të Evropës Lindore drejt liberalizimit dhe integritit tregtar me platforma të njëjta mbas viteve '90, jo të gjitha vendet e trajtuan kalimin e periudhës komuniste në mënyrë të ngjashme. Po kështu edhe Shqipëria gjatë kësaj periudhe tranzicioni ka kaluar përmes zhvillimeve të ngadalta në përgjithësi. Gjatë dekadës së parë nga anëtarësimi i Shqipërisë në OBT, bilanci tregtar në Shqipëri nuk ka reflektuar pritshmëritë e avantazheve që ofron një regjim liberal dhe integrues i tregtisë duke shënuar nivele të larta të deficitit tregtar. Gjatë pesë viteve 2010-2014 të fundit vërehet një kthesë ku eksportet rezultojnë të mbulojnë importet afërsisht me 40% krahasuar me 25% që i përkasin 10-vjeçarit 2000-2009. Në këtë material do të reflektohen propozime në kuadrin e zhvillimit të reformave strukturore dhe institucionale drejt integritit rajonal dhe më gjerë të Shqipërisë në aspektin e tregtisë ndërkombëtare në respektim të arritjes së avantazheve që ofrojnë marrëveshjet e tregtisë së lirë.

Fjalë kyç: *Tregtia e jashtme, liberalizimi tregtar, marrëveshjet e tregtisë së lirë, Shqipëria*

1. Hyrje

Shqipëria tashmë prej 25 vitesh operon në një regjim të liberalizuar të tregtisë ndërkombëtare. Ndërmarrja e reformave të ndryshme tregtare përgjatë këtyre viteve, tranzicioni politik dhe ekonomik si dhe synimet drejt aderimit në BE kanë rezultuar në paraqitjen e situatave ku kthesat ndryshme herë herë drejt përmirësimit dhe herë të tjera drejt ngadalësimit të stabilitetit makroekonomik ka qenë prezent. Këto situata kanë bërë që arritja e aftësive konkurruese të sektorëve prodhues apo shërbimeve në vend të jetë akoma në trazicion dhe gjithashtu ka reflektuar në një deficit të lartë tregtar ndër vite.

Tregtia njihet si një motor i ekonomisë së një vendi, e cila angazhon burime dhe kapacitete në funksion të përmirësimit dhe nxitjes së përmirësimit të klimës ekonomike të tij. Shqipëria për arsye të një tranzicioni të tej zgjatur dhe me shumë problematika pasqyron shumë pak evidence dhe historik të pakët mbi ndërmarrjet, politikat dhe reformat e ndërmarrja në aspektin e veprimtarisë së tregtisë ndërkombëtare në këto dy dekada e gjysmë të fundit. Për këtë arsye, është vlerësuar e nevojshme një pasqyrim i çështjeve më të rëndësishme të sektorit të tregtisë ndërkombëtare nën vështrimin e synimit drejt liberalizimit të saj. Në këtë shkrim është pasqyruar një përmbledhje e angazhimeve të Shqipërisë përmes marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe më gjerë drejt liberalizimit. Ky shkrim është i ndarë në katër sesione ku në tre sesionet e para përshkruhet veprimtaritë e reformave dhe politikave drejt krijimit të një tregu të lirë si dhe analizohen të dhënat bazë mbi zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare për periudhat 1990-1999, 2010-2009 dhe 2010-2014. Në pjesën e fundit pasqyrohet një analizë e problematikave të përjetuara në këtë periudhë 25 vjeçare dhe rekomandime të cilat hapin rruge për përmirësime në reforma në të ardhmen.

Për përgatitjen e këtij shkrimi janë shqyrtuar materiale të ndryshme akademike që hedhin sado pak dritë rreth politikave, reformave, marrëveshjeve ndërkombëtare apo edhe strukturave që janë ndërmarrë gjatë këtyre viteve. Gjithashtu për analizën rreth indikatorëve të tregtisë së jashtme në Shqipëri janë përdorur të dhëna nga institute të statistikave dhe banka botërore.

Vlen për t'u theksuar se literatura rreth tregtisë së jashtme për Shqipërinë është mjaft e kufizuar në aspektin e pasqyrimin sa më të plotë të situatës së kohës duke na mundur shumë pak hapësira për analiza dhe vlerësime rreth politikave të brendshme mbi tregtinë e jashtme. Nga pikëpamja e statistikave, institute të statistikave mundëson të dhëna bazë mbi eksportet dhe importet e mallrave, pa përllogaritje mbi importet dhe eksportet e shërbimeve apo edhe të dhëna të tjera makroekonomike.

Studime të mëtejshme për të pasuruar literaturën analizat duhen ndërmarrë në mënyrë që të vijohet me një vlerësim më të hollësishëm të rekomandimeve rreth përmirësimit të veprimtarisë së tregtisë ndërkombëtare në Shqipëri.

2. Vitet 1990-1999

2.1. Reformat, politikat e brendshme, strukturat

Me rënien e sistemit komunist në fillim vitet 1990, vendi ynë u përball me përmbysjen e madhe të veprimtarive ekonomike. Kjo përmbysje e madhe filloi me liberalizimin e tregtisë ku çdo element i lidhur me veprimtaritë ekonomike po kalonte në disa faza të tjera zhvillimi si reforma e çmimeve, ndryshimi i ligjeve në fuqi, krijimi i tregut valutor, ristrukturimi i tarifave të importit apo edhe reforma fiskale.

Reformimi i ekonomisë në Shqipëri drejt një ekonomie të liberalizuar u shoqërua me ndryshime në sistemin e ligjeve të trashëguara nga periudha e diktaturës. Në vitet e para u shfuqizua Kushtetuta e vitit '76 dhe u miratuan në vijim dispozitat kushtetuese të cilat i hapën rrugë ndryshimeve në ekonominë e tregut të lirë dhe hartimit të kodeve dhe ligjeve, që mundësonin dhe rregullonin marrëdhëniet e reja ekonomike, si ato pronësore, ato për liberalizimin e prodhimit dhe të tregtisë krahas çmimeve, ligjet që krijuan sistemin financiar dyshkallësh dhe mundësonin një politikë monetare me synim stabilizimin e monedhës vendase, për të kaluar në një bankë qendrore të pavarur dhe banka private etj. Ndryshime pësoi edhe sistemi fiskal.

Shqipëria kishte një trashëgimi shumë të varfër në sistemin e doganave me një mungesë të legjislacionit doganor të infrastrukturës dhe mjeteve, dhe personel të pakët e të pakualifikuar. Reforma synonte të krijonte një instrument fiskal e tregtar modern si dhe të riorganizonte në tërë aspektet atë. Brenda një kohe të shkurtër u hartua Kodi Doganor (1992) dhe ligji për tarifën doganore, të cilat në vite u përsosën dhe u rihartuan duke ju përshtatur standardeve të Bashkimit Europian, duke aderuar në strukturat ndërkombëtare dhe duke bërë marrëveshje të shumta dypalëshe. (Meksi, 2001)

Reformat dhe masat e ndërmarrja gjatë këtyre viteve shënuan hapa pozitivë drejt liberalizimit dhe integritit të vendit drejt tregjeve të huaja ashtu si edhe sollën mjaft vështirësi dhe pengesa duke zgjatur periudhën e tranzicionit ekonomik.

Konvertimi i monedhës vendase ndikoi pozitivisht në prodhimin vendas, pasi adoptimi me një regjim tarifash konvertimi kapërceu efektivisht një pengesë të madhe për përfshirjen në importe dhe gjithashtu në integrimin e ekonomisë shqiptare në atë botërore (Meksi, 2000; Muço, 1997).

Në përmbushjen e nevojave të tregut me mallra, një rol të rëndësishëm luajti dhe heqja e monopolit të shtetit mbi tregtinë e jashtme, domethënë liberalizimi i plotë i saj duke mënjeluar në kohë sistemin e kufizimeve dhe licencimet. Ligji mbi ndërmarrjet shtetërore, u dha të gjithë firmave të drejtën për të ushtruar aktivitet tregtar me jashtë, pavarësisht nga pronësia e tyre.

Edhe pse gjatë viteve 1980-1990 tregtia kishte filluar të orientohej drejt vendeve të industrializuara, konkurrenca e produkteve shqiptare për të hyrë në këto tregje ishte shumë e ulët, me përjashtim të kromit, bakrit dhe të energjisë elektrike. (Muço, 1997)

Reformat politike dhe ekonomike të viteve 1990-1991, u shoqëruan nga një presion në rritje për importe më të mëdha mallrash konsumi që rezultoi në thellimin e deficitit kohrent si në monedha të konvertueshme ashtu edhe në rubla. (BSH2, 1999)

Me fundin e monopolit të shtetit, tavanet u bënë instrumenti kryesor për kontrollin e importit. Në fillim, struktura e tyre ishte relativisht uniforme, me tarifa të ulëta. Me pas në mesin e viteve 1990, ajo u bë më komplekse dhe më pas u kthye përsëri në një strukturë të thjeshtë me tarifa të ulëta, për t'iu përmbajtur kërkesave për aderim në OBT. Duke filluar nga viti 1991, kufizimet sasiore mbi eksportet dhe importet iu nënshtruan një procesi reduktimi dhe eliminimi. (Mançellari, 2005).

Përpjekje serioze u bë në liberalizimin e çmimeve dhe reformës për tregun e lirë. Brenda një periudhe mjaft të shkurtër, u hoqën një pjesë e mirë e çmimeve dhe tregtia e jashtme u liberalizua. Hapja e shpejtë ndaj tregtisë dhe liberalizimi krijuan mundësitë për të rritur disponueshmërinë e mallrave në treg dhe për të eliminuar mungesat. Nën kushtet e reja mallrat shqiptare filluan të përballëshin me standardet ndërkombëtare, por aftësia e tyre për të konkurruar ishte shumë e dobët. Ky mund të quhet një tjetër faktor që shkaktoi rënien në kolaps të prodhimit dhe eksporteve.

Ndërkohë Shqipëria pësoi një krizë të veçantë në vitin 1997. Në dritën e izolimit të saj të mëparshme, vendi kishte bërë përparim të madh drejt ekonomisë së tregut. Megjithatë, zhvillimi i sektorit financiar ishte i kufizuar, dhe sistemi zyrtar bankar ishte në agoni. Në vend të kësaj, një treg informal kredia kishte filluar të ndërtohej dhe finançohej përmes remitancave (Jarvis, 1999).

Shqipëria tentoi të aplikojë reforma të shpejta dhe fillimisht njohu një farë progresi. Mirëpo periudha tranzitore u zgjat në vijimësi për shkak edhe të sfidave ekonomike dhe shoqërore.

Në një studim të ndërmarrë nga ASLUND et al., për 23 vende post-komuniste nga Bashkimi Sovjetik dhe Evropa Qendrore, rezultoi se Shqipëria ka qenë vendi me një arritje surprizuese mes ekonomive në tranzicion, e cila edhe pse një ndër vendet më të varfra ishte ndër ato që kishin një performancë më të mirë. Pavarësisht kësaj, Shqipëria vendosi të ndërmerre reforma radikale, të stabilizonte dhe përshpejtonte tregun shumë më shpejt, fakt i cili solli si rezultat edhe pengesa në ritmet e rritjes së mëtejshme.

2.2. Marrëveshjet për liberalizimin e tregtisë

Në vitin 1991 u negociua marrëveshja e parë ekonomike me Komunitetin Evropian, sipas të cilës secila palë do t'i njihte tjetrës statusin e "kombit të favorizuar". Për dekada me radhë Shqipëria ishte subjekt i të gjitha kontrolleve të Shteteve të Bashkuara mbi eksportet drejt vendeve të Evropës Lindore. (Zickel, R.E. and Iwaskiw, W. R., 1994).

Në aspektin e integritit rajonal Shqipëria nënshkroi në Maj të vitit 1992 marrëveshjen ndërmjet Komunitetit Ekonomik Evropian mbi tregtinë dhe bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik. Objektivi i Marrëveshjes synon lehtësimin dhe promovimin e vendeve në zhvillimin harmonik dhe diversifikimin e tregtisë ndërmjet tyre, si dhe zhvillimin e llojeve të ndryshme të bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik. Marrëveshja është e ngjashme me ata të nënshkruar për herë të parë me shtetet baltike dhe është e shoqëruar nga një deklaratë në dialog politik. Zbatimi i parimit të mosdiskriminimit dhe të klauzolës më të favorizuar të kombit për të tregtuar në të gjitha produktet e as palës së origjinë.

Kjo marrëveshje është ndërmarrë nga Komuniteti për të mbështetur anëtarësimin e Shqipërisë në OBT-së apo edhe në konventa të tjera në të cilat Komuniteti është pale.

Shqipëria reagoi mjaft shpejt ndaj liberalizimit të çmimeve, shkatërroi monopolet shtetërore dhe futi konvertimin e monedhës vendase. Gjithsesi, pritshmëritë europiane nuk u përmbushën në aspektin cilësor dhe sasior. Konfliktet e thella të politikës së brendshme në Shqipërisë në vitin 1997, sollën një kufizim të integritit të mëtejshëm të liberalizimit.

2.3. Tregtia e jashtme në shifra

Tregtia e jashtme e Shqipërisë është karakterizuar nga një proces rritjeje të flukseve tregtare gjatë dy dekadave të fundit (importe dhe eksporte). Duke iu referuar importeve dhe eksporteve vërehet se tregtia e Shqipërisë është e dominuar kryesisht nga veprimtaritë e importit me një bilanc negativ.

Gjatë dekadës së parë që shoqëroi kapitullimin e sistemit komunist, tregtia e jashtme në Shqipëri reflektoi pasqyrat e një fillim tranzicioni të mirëfilltë. Eksporti i Shqipërisë ka paraqitur për më shumë se një dekadë mbas viteve 1990 rreth një të katërtën e importit (mesatarisht 27.1% përgjatë viteve 1990-1999). Pavarësisht kësaj, deficitit tregtar mbetet në nivele të larta duke reflektuar një pamundësi përdorimi në mënyrë sa më efektive burimet vendase.

TABELA 1: TË DHËNAT MBI TREGTINË E JASHTME 1990-1999

Vitet	Eksporte	Importe	Bilanci Tregtar	Tregtia për BBP	Importi për frymë	Rritje Import
	Në milionë dollarë			Në %	Në USD	Në %
1990	230.00	380.00	(150.00)	26.1%	148.33	
1991	100.00	410.00	(310.00)	24.3%	96.22	7.9%
1992	70.00	540.00	(470.00)	53.5%	193.39	31.7%
1993	122.47	571.59	(449.12)	97.8%	237.04	5.8%


1994	141.39	602.23	(460.83)	60.5%	241.13	5.4%
1995	201.25	711.49	(510.24)	45.9%	262.48	18.1%
1996	210.53	938.37	(727.84)	47.5%	335.09	31.9%
1997	141.30	638.03	(496.72)	25.9%	256.29	-32.0%
1998	206.48	838.23	(631.75)	47.5%	299.70	31.4%
1999	351.73	1,158.14	(806.41)	55.3%	353.84	38.2%

Burime: INSTAT¹, Statistika OBT², Banka Botërore³, Trading economies⁴, përlllogaritje personale⁵

Gjatë viteve 1990-1999, aktivitetet tregtare u fokusuan në liberalizimin e tregtisë dhe reforma strukturore për të nxitur performancën ekonomike përmes heqjes së kuotave, kufizimeve të eksportit, dhe kontrollet e këmbimit të huaj, si dhe zvogëlimin e tarifave. Vitet e para të tranzicionit tregojnë një ngurtësi ndaj hapjes drejt tregtisë së lirë. Ky fakt shoqërohet nga shumë faktorë makroekonomikë dhe politikë të periudhës. Deri përpara zgjedhjeve të para pluraliste të vitit 1992, tregtia vijonte të përbënte një rëndësi shumë të vogël të ekonomisë sonë. Ndërkohë me masat e ndërmarra drejt krijimit të kushteve të përshtashme drejt liberalizimit të tregtisë filluan të tregonin karakteristikën specifike që zakonisht kanë vendet e vogla, varësinë ndaj tregtisë së jashtme. Shenjat drejt hapjes ndaj tregtisë (raportet⁶ Tregtia në PBB, Import për frymë dhe rritja e importeve) edhe pse mjaft të vakëta, pasqyrohen lehtë në raportin e importit të mallrave dhe shërbimeve ndaj numrit të popullatës. Një arsye për këtë janë mos adaptimi siç duhet masave të pranuar në marrëveshjet e tregtisë së lirë për ulje të barrierave tarifore apo edhe konflikteve të brendshme të vitit 1997.

Rritja e importeve në këtë periudhë rezulton mesatarisht në vlera afërsisht në 15%. Kjo normë, por gjithmonë e shoqëruar edhe me reflektimet e indikatorëve të tjerë tregojnë për hapat e parë drejt procesit të integritimit me plot dinamika.

GRAFIKU 1: MARRËDHËNIET TREGTARE ME VENDET E MTL⁷



Burimi: INSTAT⁸

Në një vështrim të marrëdhënieve tregtare dhe integritimit të Shqipërisë në raport me vendet e me të cilat ka nënshkruar marrëveshje të tregtisë së lire duke përfshirë edhe Turqinë, gjatë dekadës së parë pas rënies së sistemit komunist shikohet një rënie e ndjeshme e eksporteve nga rreth 15% të eksporteve me Evropën në vitin 1993 në 3-4% në fund të viteve 90-të. Importet ndërkohë kanë reflektuar një qëndrueshmëri më të mirë duke treguar marrëdhënie pothuajse të njëjta me këto vende nga 7% në vitin 1993 dhe 8% në fund të këtij 10 vjeçari. Kriza e vitit 1997 shënon një rënie drastike të eksporteve duke arritur nivelin më të ulët të bashkëpunimit në këtë periudhë në dy vitet e ardhshme.

Pavarësisht kësaj, me synimin drejt integritimit në BE, u ndërmorën masa për zbutjen e tavanit të tarifave të importit duke i ulur ndjeshëm nga 19% mesatarisht që ishin në vitin 1990 në afërsisht 14% në vitin 1999. Kjo edhe në vijim lehtësoi klimën e aderimit dhe anëtarësinë në OBT⁹ si anëtare me të drejta të plota.

INSTAT: Të dhëna mbi import-eksportin e qarkullimit të mallrave. (1993-1999).

Statistika OBT: Të dhëna mbi import-eksport të qarkullimit të mallrave. (1990-1992).

Banka Botërore: Të dhëna mbi numrin e popullsisë dhe flukset e importit për mallra dhe shërbime.

Trading economies: Të dhëna mbi PBB të Shqipërisë. Marrë nga <http://www.tradingeconomics.com/albania/gdp>.

Përlllogaritje personale: përlllogaritjet e raporteve për hapjen e tregtisë.

Këto raporte janë marrë si referencë nga Open Market Indeks i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.

Vendet e përfshira në MTL: Kroacia, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi, Kosova, Turqia.

Instituti i Statistikave.

Organizata Botërore e Tregtisë.

TABELA 2: TARIFAT MESATARE TË IMPORTIT

Vitet	Tarifa Mesatare
1991	19.0%
1999	14.1%

Burimi: OBT

3. Vitet 2000-2009

3.1. Reformat dhe marrëveshjet për liberalizimin e tregtisë.

Proceset e integrimit ekonomik dhe tregtar shumëpalëshe, evropiane dhe ato rajonale u intensifikuan përgjatë viteve 2000-2009. Liberalizimi i tregut dhe zhvillimi i mëtejshëm i tregtisë së jashtme, u përshpejtua nga aderimi i vendit në OBT në vitin 2000.

Shqipëria ashtu si dhe shumë shtete të tjera u bë anëtarë me të drejta dhe detyrime të plota në OBT, pas dorëzimit dhe ratifikimit të protokollit të anëtarësimit në bazë të nenit XII të marrëveshjes së OBT-së. Statusi me të cilin Shqipëria ka hyrë në OBT është ai vendit me ekonomi në tranzicion. Nga një vështrim i përgjithshëm që i bëhet protokollit vihen re dy kategori detyrimesh. Të para janë në terma konkrete dhe konsistojnë në plotësim angazhimeve të llojit reduktim tarifash dhe liberalizim shërbimesh, të cilat do të realizohen duke zbatuar parimet e sipërpërmendura të OBT-së. Kategoria e dytë ka të bëjë më harmonizimin e ligjeve dhe sjelljen e tyre në përputhje mosmarrëveshjet e Raundit të Uruguait. Marrëveshje të veçanta kërkojnë që kjo sjellje të jetë vazhdueshme dhe Shqipëria duhet të njoftojë OBT-në sa herë që nxjerr apo amendon ndonjë ligj, që prek fushat që lidhen me to. (Gugu, 2004)

Me iniciativë të Bashkimit Europian një memorandum mirëkuptimi mbi liberalizimin dhe lehtësimin e tregtisë u nënshkrua më 27 Qershor 2001 në Bruksel nga ministrat e jashtëm të Evropës Juglindore. Ky memorandum parashikon nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale të tregtisë së lirë mes shtatë vendeve të Evropës Juglindore me qëllim uljen dhe eliminimin e barrierave tarifore. (Della Posta et al., 2009).

Nënshkrimi i CEFTA në 2006, solli një frymë të re drejt reformave që do të mundësonin një treg më të hapur dhe të lirë për Shqipërinë. Më 19 dhjetor 2006, të gjitha marrëveshjet dypalëshe që Shqipëria kishte lidhur me vendet e rajonit u transformuan në një marrëveshje shumëpalëshe, Marrëveshja e Tregtisë së Lirë së Evropës Qendrore (CEFTA 2006), e cila përfshin tetë vende: Shqipëri, Maqedoni, Mal i Zi, Kosovë, Moldavi, Kroaci, Serbi dhe Bosnjë Hercegovinë. Objektivat kryesore të CEFTA-s janë ndër të tjera, zgjerimi i tregtisë në mallra dhe shërbime dhe nxitja e investimeve, eliminimi i barrierave të tregtisë mes palëve, sigurimi i mbrojtjes së duhur të së drejtave të pronësisë intelektuale në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe harmonizimi i dispozitave për sa i përket çështjeve të politikave tregtare, të tilla si: rregullat e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore. Ajo gjithashtu përfshin procedura të qarta dhe efektive për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit (MSA) në Luksemburg më 12 qershor 2006, u vlerësua si e nevojshme forcimi i mëtejshëm dhe zhvillimi i marrëdhënieve tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të BE. Për këtë arsye një Marrëveshja e Përkohshme e cila hyri në fuqi që nga 1 dhjetori 2006, lejoi tregtinë dhe të dispozitat e MSA të lidhura me tregtinë të hyjnë në fuqi. Marrëveshja e Përkohshme zëvendësoi Marrëveshjen e Tregtisë dhe të Bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian, dhe në kishte për qëllim krijimin e një zonë të tregtisë së lirë midis Shqipërisë dhe BE brenda një periudhe 10 vjeçare. Sipas kësaj marrëveshje, tarifat doganore mbi produktet industriale 8 shqiptare që hyjnë në tregun evropian reduktoheshin në zero. I njëjti rregull vlen edhe për shumicën e produkteve bujqësore shqiptare, ndërsa për detyrimet e tjera doganore do të reduktoheshin deri sa ata të zeroheshin. (Albinvest, 2008). MSA u ratifikua në prill 2009 dhe zëvendësoi Marrëveshjen e Ndërmjetme, e cila tashmë është pjesë integrale e MSA.

Në dhjetor 2009, Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë me Shoqatën Evropiane të Tregtisë së Lirë (EFTA). Shtetet anëtare të EFTA- s janë Islanda, Zvicra, Norvegjia dhe Lihtenshtajni. Marrëveshja e Tregtisë së Lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të EFTA përqendrohet në liberalizimin e tregtisë së mallrave. Ato do të shfuqizojnë të gjitha tarifat doganore mbi produktet industriale, përfshirë peshqit dhe produktet e tjera detare. Marrëveshjet dypalëshe për produktet bujqësore ndërmjet shteteve të EFTA- s (individualisht) dhe Shqipërisë bëjnë pjesë gjithashtu tek instrumentet krijues të zonës së tregtisë së lirë ndërmjet të dy palëve.

Shqipëria ka gjithashtu një Marrëveshje të Tregtisë së Lirë me Turqinë, të nënshkruar në 2006, e cila ka hyrë në fuqi në maj 2008. Njëpërmjet kësaj Marrëveshje dy vendeve u krijohen mundësi për rritjen e shkëmbimeve tregtare ndërmjet tyre. Sipas marrëveshjes, nuk do të ketë tarifa për mallrat industriale shqiptare të eksportuara në Turqi dhe tarifat për produkte të caktuara turke do të reduktohet përfundimisht brenda pesë vitesh. Lidhur me produktet bujqësore palët i kanë akorduar reciprokisht njëra-tjetrës kuota tarifore.

3.2. Tregtia në shifra

Bilanci tregtar në Shqipëri në dekadën e parë nga anëtarësimi i Shqipërisë në OBT nuk ka reflektuar pritshmëritë e avantazheve që ofron një regjim liberal dhe integrues i tregtisë duke shënuar nivele të lartë deficiti. Gjatë periudhës 10-vjeçare (2000-2009) vërehet një rritje graduale si në eksport edhe në import, duke përjashtuar vitet 2000 dhe 2009 ku vërehet rënie në të dy këto elementë. Në vitin 2009 vërehet një tkurrje prej 7.2 përqind dhe 2.5 përqind në eksport dhe import përkatësisht krahasuar me një vit më përpara. Në vitin 2009 përqindja e mbulimit është 24.4 përqind, nga 23.6 përqind që ishte në vitin 2000. Gjatë kësaj periudhe vërehet rritje mesatare vjetore e eksporteve në 14.2% përqind dhe importeve 15.5% në importe.


TABELA 3: TË DHËNAT MBI TREGTINË E JASHTME 2000-2009

Vitet	Eksporte	Importe	Bilanci Tregtar	Tregtia për BBP	Importi për frymë	Rritje Import
	Në milionë dollarë			Në %	Në USD	Në %
2000	257.72	1,093.24	(835.51)	39.4%	447.43	-5.6%
2001	307.33	1,325.30	(1,017.97)	44.2%	516.84	21.2%
2002	338.85	1,501.02	(1,162.16)	45.0%	681.19	13.3%
2003	447.13	1,854.44	(1,407.32)	51.7%	854.73	23.5%
2004	604.41	2,296.87	(1,692.46)	51.3%	1,072.32	23.9%
2005	658.97	2,625.06	(1,966.09)	44.0%	1,296.64	14.3%
2006	789.04	3,049.41	(2,260.37)	45.8%	1,512.37	16.2%
2007	1,074.54	4,160.06	(3,085.51)	57.3%	2,000.69	36.4%
2008	1,340.30	5,237.46	(3,897.15)	61.5%	2,496.04	25.9%
2009	1,100.39	4,515.04	(3,414.65)	43.6%	2,244.84	-13.8%

Burime: INSTAT, Statistika OBT, Banka Botërore, Trading economies, përlogaritje personale

Me anëtarësimin në OBT dhe kushtet e parashikuara në anëtarësim, vërehet një hapje drejt liberalizimit të tregtisë. Tregtia e jashtme vijon të mbetet një nga përbërësit kryesorë të prodhimit të brendshëm bruto për vitet 2000-2009. Ekonomia shqiptare varet afërsisht në 50 përqind nga tregtia e jashtme dhe këto shifra tregojnë se vendi ynë ka synuar në vazhdimësi drejt politikave liberalizuese ndaj tregtisë. Kjo dekadë e dytë e tranzicionit, reflektoi një tendencë rritëse në vlerën e importeve për frymë. Kjo lidhet shumë si me uljen e barrierave të importit dhe tregojnë për qasjet liberalizuese të politikave tregtare. Rritja e importeve në këtë periudhë rezulton mesatarisht në vlera 16 përqind. Krahasuar me dekadën e paraardhëse, rritja ka qenë në të njëjtat nivele duke treguar për një aktivitet tregtar të pastimular dhe me ritme rritjeje të ngadalta. Pavarësisht masave që janë ndërmarrë në kuadrin e liberalizimit dhe hapjes ndaj tregtisë së lirë nuk janë shoqëruar me shfrytëzimin maksimal të burimeve kombëtare në funksion të importeve.

GRAFIKU 2: MARRËDHËNIET TREGTARE ME VENDET E MTL



Burimi: INSTAT

Gjatë këtij 10-vjeçari eksportet dhe importet e vendit kanë ndjekur tendenca të ngjashme me njëri tjetrin. Anëtarësimi në OBT dhe nënshkrimet e njëpasnjëshme të marrëveshjeve për tregtinë e lirë me vendet CEFTA, reflektojnë një përmirësim të bilancit tregtar me këto vende gjatë këtij 10 vjeçari. Marrëdhëniet e eksporteve në fillim vitet 2000 përfaqësonin 4% të eksporteve me vendet e Evropës ndërkohë që në fund të 10 vjeçarit këto marrëdhënie arritën në 14%. Gjithashtu edhe importet kanë treguar rritje duke përmirësuar ndjeshëm edhe bilancin tregtar me këto vende kryesisht në pesë vjeçarin e dytë të kësaj dekade.

Pavarësisht kësaj, konkurrenca e mallrave shqiptare vijon të mbetet një problematikë aktuale e kësaj periudhe. Pavarësisht nga këto zhvillime, Shqipëria është përballur në këto dy dekada me probleme serioze makro-të tregtisë dhe me një konkurrueshmëri të ulët të produkteve dhe firmave shqiptare në tregjet ndërkombëtare. Prapambetja e trashëguar nga regjimi i mëparshëm 10 paqëndrueshmëria e reformave strukturale e institucionale kanë reflektuar një gjendje të kufizimit të zhvillimeve të strategjive dhe ndërmarrjes së reformave mbi tregtinë e jashtme. Zhvillimi i këtyre reformave do t'i kishte hapur rrugë zgjidhjes së problematikave që lidhen zhvillimin e tregtisë në Shqipëri (Mancellari,2005).

Tarifat mesatare të importit pësuan një rënie drastike dhe u thjeshtëzuan duke mundësuar një treg shqiptar dhe tregti me jashtë të liberalizuar dhe hapa konkretë drejt integritimit me tregun europian.

TABELA 4: TARIFAT MESATARE TË IMPORTIT

Vitet	Tarifa Mesatare
1991	9.9%
1999	5.0%

Burimi: OBT

4. Vitet 2010-2014

4.1. Tregtia në shifra

Përgjatë pesë viteve të fundit, vërehet një përmirësim i lehtë në bilancin tregtar, ku reflektohet një zgjerim i eksporteve mesatarisht me 16.2% dhe importeve me 1.3%, por gjithsesi të pamjaftueshëm për një përmirësim të aktivitetit tregtar.

Gjatë pesë viteve 2010- 2014 të fundit vërehet një kthesë ku eksportet rezultojnë të mbulojnë importet afërsisht me 40% krahasuar me 25% që i përkasin 10-vjeçarit 2000- 2009. Përmirësimi i bilancit vjen përgjithësisht për shkak se eksportet shqiptare kanë përsheptuar ndjeshëm ritmin e rritjes në vitet e fundit. Kjo tendencë e re e eksporteve shqiptare është analizuar duke synuar evidentimin e sektorëve specifikë dhe partnerëve tregtarë që kanë ndikuar këtë orientim të ri të tregtisë së jashtme.

TABELA 5: TË DHËNAT MBI TREGTINË E JASHTME 2010-2014


Vitet	Eksporte	Importe	Bilanci Tregtar	Tregtia për BBP	Importi për frymë	Rritje Import
	Në milionë dollarë			Në %	Në USD	Në %
2010	1,553	4,594	(3,041)	51.1%	2,214	1.7%
2011	1,831	5,059	(3,228)	57.7%	2,586	10.1%
2012	2,013	4,993	(2,980)	54.3%	2,286	-1.3%
2013	2,419	5,079	(2,660)	60.8%	2,464	1.7%
2014	2,220	4,793	(2,573)	54.4%	1,818	-5.6

Burime: INSTAT, Statistika OBT, Banka Botërore, Trading economies,përlllogaritje personale

Pesë vitet e fundit, tregtia ka rritur prezencën në ekonominë e vendit, duke treguar për një drejtim drejt transaksioneve të tregtisë së jashtme. Pavarësisht faktit se heqja e barrierave të lëvizjes së lirë së qytetarëve, lehtësimet e proceseve doganore dhe politikat liberalizuese ndaj 11 investimeve të huaja në Shqipëri do të ndikojnë më shumë në përmirësimin e klimës liberalizuese, mirëpo efektet e kolapsit tregtar global dhe krizat financiare që preken vendet fqinje dhe me të cilat jemi të lidhur ngushtësisht reflektuan në një ngadalësim të zgjerimit të importeve apo edhe raportit për frymë.

Sipas analizave të Bankës së Shqipërisë për 6-mujorin e parë të vitit 2014, vlerësohet se aftësia dhe rritja afatgjatë e ekonomisë së Shqipërisë duhet mbështetur përmes diversifikimit horizontal të gamës së produkteve të eksportuara dhe duke rritur vertikalisht vlerën e të këtyre produkteve. (BSH12, 2014).

GRAFIKU 3: MARRËVESHJET TREGTARE ME MTL



Burimi: INSTAT

Vitet 2010-2014, shënojnë një bashkëpunim më të madh mes vendeve CEFTA dhe Shqipërisë. Nivelet e importit dhe eksportit me këto vende arrijnë në nivelin e 17% të tregtisë në raport me vendet e Evropës.

Reformat e tarifave mbi importin gjithashtu kanë vijuar në rënien e mëtejshme duke krijuar kushte mjaft liberalizuese dhe integruese për Shqipërinë.

TABELA 6: TARIFAT MESATARE TË IMPORTIT

Vitet	Tarifa Mesatare
1991	5.0%
1999	3.8

Burimi: OBT¹⁰

5. Problematikat e liberalizimit dhe integritit tregtar

Liberalizimi tregtar dhe hapja ndaj tregjeve të huaja është influencuar së tepërmi nga asociimi i vendit në OBT si dhe procesi i integritit evropian në të cilin ai është përfshirë. Si rezultat Shqipëria është përballur me një numër sfidash si:

konkurrueshmëria e dobët e ekonomisë ndërkohë që deficitin ekonomik mjaft i lartë, duke sjellë si rezultat një shkallë të ulët të hapjes së ekonomisë dhe një deficit të lartë gjithashtu (Mancellari, 2005; Ceku, 2003; Jaupllari, 2013). efektet pozitive të integritit në ekonominë rajonale në kuadër të MTL dypalëshe janë të pamjaftueshme; (Mancellari, 2005).

Të gjithë këto probleme lidhur me tregtinë, kërkojnë vëmendje dhe analizë të thelluar.

Studiues të ndryshëm nga fusha e integritit ekonomik sugjerojnë se tregtia aktuale mund të ndikohet nga tregtia e mëparshme. Për shembull, disa autorë argumentojnë tregtia aktuale e një vendi shpeshherë mbetet e influencuar nga tregtia e hershme përmes konceptit “formimi i zakonit”. Me fjalë të tjera, në qoftë se konsumatorët kanë qenë duke përdorur një produkt të veçantë gjatë viteve të fundit, ata do të mësohen me përdorimin e atij produkti duke e kthyer në formë zakoni. Ky “formim zakoni” do të mundësojë një kontribut në tregtinë e tanishme dhe të ardhshme (Bun dhe Klaassen, 2002).

Përveç cilësisë së tyre të ulët, paketë e dobët dhe mungesa e reklamimi duket se rruga e shpejtë ndjekur, pa stimulimin e parë çdo lloj të konkurrencës së brendshme, ka kontribuar fuqimisht në rritjen e shpenzimeve të përshtatjes. Zgjerimi i sektorit privat dhe frymën sipërmarrëse të shqiptarëve pritet të përmirësojë situatën dhe për t’u përballur me sfidën se tregu sapo zhvillim është ofruar (Muço, 1997).

6. Propozime rreth politikave mbi tregtinë ndërkombëtare

Liberalizimi dhe integriti tregtar janë thelbësorë në ndërtimin e një ekonomie të hapur dhe për forcimin e konkurrencës së ekonomisë vendase për t’u përballur me importin dhe përmirësojë performancën e eksportuesve. Një ekonomi siç është ajo e Shqipërisë, me kapacitet relativisht të vogël, duhet që të kërkojë mundësitë për zhvillimin hapjes së ekonomisë të mëtejshme përmes tregut të lirë dhe liberalizimit tregtar. Marrëveshjet e tregtisë së lirë të vendit tonë me vendet e tjera të rajonit, duhet të shoqërohen me paketa dhe me politika inkurajuese që kanë për objektin zhvillimin dhe përdorimin e burimeve të brendshme.

Banka e Shqipërisë.

Banka Botërore në një publikim të saj, propozon disa mekanizma kombëtare të cilat ndihmojnë vendet në trajtimin e liberalizimit në funksion të zhvillimit ekonomik dhe uljes së varfërisë. Fushat që kërkojnë fokus të veçantë zhvillimi janë konkurrenca tregtare, financimi i tregtisë, 13 lehtësimi dhe logjistika, kooperimi tregtar si dhe sistemet e informacionit, treguesit dhe të dhënat mbi tregtinë (WBG¹¹, 2010).

Organizma të tjera ndërkombëtare gjithashtu propozojnë përmes programeve të tyre sugjerime dhe alternativa për përmirësimin e kapaciteteve dhe reformimeve strukturore të brendshme për zhvillimin dhe liberalizimin e tregtisë së jashtme të një vendi. Disa nga opsionet që do t'i vinin në ndihmesë tregut shqiptar në kushtet aktuale janë si më poshtë;

Koordinimi i duhur

Tregtia shoqëron të gjithë sektorët e ekonomisë. Kompleksiteti i tregtisë dhe ndërvarja me zhvillimin e përgjithshëm të një vendi e bën koordinimin thelbësor. Shqipëria në kontekstin teorik apo edhe të retorikës politike e një rëndësinë që luan tregtia në ekonominë e vendit, mirëpo nga pikëpamja e ndërtimit të strategjive zbatuese për integrimin dhe thellimin e liberalizimit të tregtisë, shfaqen mangësi dhe përpjekje mjaft të dobëta. Nëse qeveria nuk e njeh tregtinë si një prioritet në strategjinë kombëtare, atëherë investitorët si të huaj apo vendas do të fokusohen drejt atyre nevojave që reflektohen si prioritete kombëtare. Politikat kombëtare ekonomike dhe tregtare mund të jetë jo koherente ose të papërcaktuara apo identifikuar qartë. Kjo do të thotë se negocimi i nevojave dhe prioriteteve shpesh nuk mund të identifikohen në mënyrë të qartë përpara fillimit të, apo edhe gjatë, negociatave tregtare. Mungesa e koherencës apo qartësisë e politikave kombëtare mund të jetë rezultat i dështimit të qeverisë për të koordinuar në mënyrë efektive tregtinë dhe bërjen e politikave ekonomike ndërmjet agjencive të saj të ndryshme dhe për të marrë kontributin e të gjithë aktorëve relevantë të politikës. (TADP South Center¹², 2004) Për vendin tonë është mjaft e rëndësishme një koordinim mes aktorëve palë në reformimet strukturore, politikat, veprimtari e të tjera të jenë pjesë integrale e një koordinimi kombëtar afatmesëm dhe afatshkurtër.

Identifikim i nevojave dhe kufizimeve

Vendet në zhvillim zakonisht vuajnë nga kufizimet e shumanshme të ofertës si dhe nga mungesa e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale. Identifikimi i nevojave dhe kufizimeve tregtare duhet të ndërtohen mbi bazën e një analize të grupeve të ndryshme interesi në mënyrë që të jenë sa më përfaqësuese dhe konkrete. Përfaqësues të qeverisë, të sektorit privat, akademikë dhe ekspertë të ndryshëm duhet të angazhohen së bashku mbi hapat që duhen ndjekur drejt zhvillimit të prioriteteve të tregtisë.

Politikëbërja e duhur: fizibiliteti i reformave

Integrimi i suksesshëm kërkon reformat e konsiderueshme. Reformat tregtare duhen fokusuar në angazhimin e sektorit privat duke gjetur një vijimësinë e duhur të reformave, aplikim i politikave 13 WBG: World Bank Group. Grupi i Bankës Botërore. 14 Ky punim është përgatitur nga stafi i Programit për Tregti dhe Zhvillim TADP të South Center me kërkesë të Zyrës së G-77 dhe Kinës në New York për Forumin e nivelit të Lartë G-77 dhe Kinë mbi Tregtinë dhe Investimet, Katar, 5-6 Dhjetor 2004. 14 plotësuese për të tkurrur deficitin, zbatimi i projekteve pilot për të treguar përfitimet dhe të tjera masa në aspektin e lehtësimit të klimës politikëbërëse. Pavarësisht kësaj, duhet treguar vëmendja e duhur në krijimin e një besueshmërie në publik, mes aktorëve të ndryshëm se reformat e ndërmarra do të jenë efektive dhe shpresëdhënëse. Tranzicioni i gjatë i Shqipërisë në shume sektorë, por edhe shpejtësia me të cilën reformat drejt liberalizimit u ndërmorën në fillim të viteve '90, reflektuan ngadalësim në rrugën drejt një ekonomie të mirëformuar dhe qenësishme duke ulur pritshmëritë e sektorit privat në ecurinë dhe zhvillimin e reformave të duhura. Eksperiencat e huaja gjithashtu kanë treguar se reformat e tregtisë janë përquasur shpesh me skepticizëm nga ana e sektorit privat. Reforma argjentinasë e fund viteve 1970, për shembull, kishte kredibilitet të tillë të ulët dhe mjaft nga drejtuesit e bizneseve kanë vepruar me skepticizëm në qasjen në mënyre serioze të tyre duke zgjedhur të mos i përgjigjen kërkesave siç nevojitej. (Rodrik, 1992). Politikat dhe strategjitë në Shqipëri duhet të fokusohen në ato drejtime të cilat sigurojnë rritje ekonomike dhe ulje të varfërisë siç janë maksimizimi i ekonomisë kombëtare, diverifikimit të eksporteve, rritjes së fluksit të tregtisë në tërësi, përmirësimit të kapaciteteve dhe krijimit të strukturave të posaçme politikëbërëse dhe promovuese (Hallaert, J. et al., 2009).

Dimensionimi rajonal: forcimi i kapaciteteve

Projektet rajonale janë katalizatorë të fuqishëm për rritjen ekonomike. Pasqyrimi i prioriteteve, përparësitë dhe kufizimeve infrastrukurore, lehtësitë tregtare dhe standartet mund të ndihmojnë një vend të përthithë potencialin dhe përfitimet e tregtisë rajonale (OECD,2009).

7. Përfundime

Tregtia është motori i një ekonomie të një vendi. Aq më tepër për një vend në zhvillim si Shqipëria, e cila mund të shfrytëzojë në maksimumin e mundshëm pozicionin gjeografik, pasuritë dhe reformat lehtësuese për t'u integruar edhe më shumë në aspektin e tregtisë me rajonin dhe më gjerë.

WBG: World Bank Group. Grupi i Bankës Botërore.

Ky punim është përgatitur nga stafi i Programit për Tregti dhe Zhvillim TADP të South Center me kërkesë të Zyrës së G-77 dhe Kinës në New York për Forumin e nivelit të Lartë G-77 dhe Kinë mbi Tregtinë dhe Investimet, Katar, 5-6 Dhjetor 2004.

Shqipëria nevojitet të ndërmarrë masa të duhura duke identifikuar qartë përmes edhe strategjive të posaçme për tregtinë nevojat, mundësitë dhe kufizimet e tregut, koordinuar së brendshmi organizmat dhe strukturat e posaçme për një harmonizim veprimesh si dhe adoptuar reforma të duhura dhe me efektivitet real.

Gjithashtu është e nevojshme që vrojtime më të thelluara të ndërmerren për të identifikuar qartë fushat dhe sektorët e posaçëm për një veprim më aktiv.

Bibliografia

- Albanian Business and Development Agency, (2008), Trade and Free Trade Agreements, Fact Sheet No.3, March.
- Aslund, A., Boone, P. & Johnson, S., (1996), How to Stabilize: Lessons from Post-communist Countries, Brookings Papers on Economic Activity, Pp217-313.
- Banka e Shqipërisë, (2014), Publikime Periodike, Buletini Ekonomik, Buletini i Bankës së Shqipërisë, 6-mujori i I-rë 2014, Tiranë, 11 Nëntor.
- Bun, M.J.G. and F.J.G.M. Klaassen (2002), Has the euro increased trade? Tinbergen Institute Discussion Paper 02-108/2, University of Amsterdam.
- Ceku, B., (2003), Rrugët e Shtimit të Eksportit Shqiptar, Konferenca IV e Bankës së Shqipërisë “Ekonomia Shqiptare: Ecuria dhe Sfidat e Politikave Ekonomike”, Sarandë, 11 - 12 SHTATOR. Marrw nga http://www.bankofalbania.org/web/pub/b_17_Fjalimi_Cekut_787_1.pdf.
- DellaPosta, P., Uvalic, M. and Verdun, M., (2009), Globalization, Development and Integration: A European Perspective, Chapter 10: Regionalism in Southeast Europe, Basingstoke, Palgrave Macmillan, pp. 176-194.
- Finger, K. M., (2011), Open market Index 2011. International Chamber of Commerce, Paris. Material available at <http://www.iccwbo.org/Data/Documents/GlobalInfluence/G20/Products/2011-Open-Markets-Index-%28OMI%29-pdf/>
- Gugu A., (LL.M.), (2004), Policy Analysis, Some Reflections on World Trade Organization and Protective Mechanisms in its Framework, Albanian Center for International Trade. Retrieved from <http://pdc.ceu.hu/archive/00002088/>
- Hallaert, J. and Munro, L., (2009), Binding Constraints to Trade Expansion: Aid for trade objectives and diagnostics tools, OECD Trade Policy Working Papers, No. 94, OECD Publishing. doi: 10.1787/5kmlbl6glf5d-en
- Jarvis, C., (1999), The Rise and Fall of the Pyramid Schemes in Albania (Working Paper WP/99/98). Retrieved from International Monetary Fund website: <http://www.imf.org/external/pubs/ft/wp/1999/wp9998.pdf>.
- Jaupaj (Tekka), S., (2013), Tregtia e Jashtme dhe Zhvillimi Ekonomik në Ndikimin e Proçeseve Liberalizuese: Rasti i Shqipërisë. Tezë Doktorature, Universiteti i Tiranës, Tiranë, Shqipëri.
- Mancellari, A. (2005), Liberalizimi Tregtar dhe MTL-te Rasti i Shqipërisë, Konferenca “Liberalizimi Tregtar në Vendet e Ballkanit Perëndimor”, Tiranë, 21 Tetor.
- Meksi, A (2001), Reforma institucionale në Shqipëri, Konferenca II e Bankës së Shqipërisë “Shqipëria midis reformave të brendshme dhe integritimit europian”, Tiranë, 6-7 Dhjetor.
- Muço, M., (1997), Economic Transition in Albania: Political Constraints and Mentality Barriers, June, NATO Individual Fellowship Program 1995-1997, June.
- Rodrik, D. (1992), The Limits of Trade Policy Reform in Developing Countries, Journal of Economic Perspectives, 6 (1): 87–105.
- South Centre, (2004), Strengthening Developing Countries’ Capacity for Trade Negotiations: Matching Technical Assistance To Negotiating Capacity Constraints, Background Paper No. 4, (Paper prepared at the request of the Office of the G77 and China in New York for the G-77 and China High-Level Forum on Trade and Investment, Doha, Qatar), 5-6 December.
- Tanku, A. dhe Ruci, E., (1999), Buletini Ekonomik, Opinione nga zhvillimet në sektorin e jashtëm, 1992-1998, Vëllimi 2, Nr.2.
- The World Bank Group, (2010), International Trade Strategy Approach Paper: Background to the Strategy and Issues for Discussion, 30 March.
- OECD/WTO, (2009), Aid for Trade at a glance 2009: Maintaining Momentum © retrieved from <http://www.oecd.org/dac/aft/43235052.pdf>.
- Zickel, R.E. and Iwaskiw, W. R., (1994). Albania: A Country Study. (2nd ed.). Washington DC. Headquarters Dept. of Army. www.aida.gov.al
www.instat.gov.al
<http://www.tradingeconomics.com/albania/gdp>
- World Bank statistics retrieved from <http://data.worldbank.org/country/albania>.
- WTO statistics retrieved from <http://stat.wto.org/TariffProfile/WSDBTariffPFHome.aspx?Language=E>

ANALIZA E PERFORMANCËS SË BANKËS KOMBËTARE TREGTARE NËPËRMJET ANALIZËS FINANCIARE

ANILDA BOZDO

Universiteti European i Tiranës, Fakulteti Ekonomisë dhe IT, Financë
anilda.bozdo@uet.edu.al

ERMELA KRIPA

Universiteti European i Tiranës, Fakulteti Ekonomisë dhe IT, Financë
ermela.kripa@uet.edu.al

ABSTRAKT

Aktiviteti i bankave tregtare në Shqipëri është karakterizuar nga ndryshime të vazhdueshme, për shkak të ngjarjeve dhe zhvillimeve gjatë periudhës të marrë në studim. Si pasojë e faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm edhe performanca e bankave tregtare në Shqipëri ka pësuar luhatje të ndjeshme nga viti në vit. Ndryshimi i rregulloreve në lidhje me mjaftueshmërinë e kapitalit, me menaxhimin e likuiditetit dhe riskut të kredisë, kanë karakterizuar ndryshimet në performancën e bankave tregtare në Shqipëri. Veçanërisht rritja e kredive me probleme dhe ulja e nivelit të cilësisë së kredive, kanë patur impaktin më të madh në këtë drejtim.

Ky punim është një përpjekje për të analizuar performancën e bankave tregtare në Shqipëri dhe sistemit bankar në përgjithësi, gjatë një periudhe 6-vjeçare (2008-2013). Fokusi i studimit qëndron në analizën e raporteve financiare dhe paraqitjen e ndikimit sasior të disa faktorëve specifikë bankarë në performancën e bankave tregtare. Nëpërmjet këtij studimi do të mund të provohet nëse performanca e Bankës Kombëtare Tregtare është ulur apo rritur gjatë kësaj periudhe dhe cili prej matësve të performancës është matës më i mirë.

Ky studim është një kontribut në literaturën ekzistuese, i cili siguron prova shtesë për ndikimin e faktorëve specifikë bankarë në performancën e bankave tregtare.

Fjalë kyç: *Sistemi Bankar Shqiptar, BKT, Performancë, Cilësi Kredie, ROE, ROA*

Hyrje

Kriza globale financiare e viteve të fundit ka sjellë pasoja negative në ekonominë e të gjithë vendeve të botës. Bankat tregtare si pjesë e rëndësishme e sistemit financiar të çdo vendi, kanë ndjerë më së shumti pasojat e kësaj krize. Kjo gjë vihet re dhe në performancën e tyre financiare.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të masë performancën e Bankës Kombëtare Tregtare duke e marrë si rast studimor. E veçanta e këtij studimi është se nuk ka në fokus analizën e sistemit bankar në tërësi, por merret më së shumti me analizimin e Bankës Kombëtare Tregtare. Për këtë arsye, studimi është punuar me kujdes të veçantë duke llogaritur raporte të ndryshme financiare, të cilat ndihmojnë në matjen e performancës financiare kësaj banke.

Ky punim mbyllet me një analizë ekonometrike. Kjo analizë realizohet për të vërtetuar hipotezën e këtij punimi. Analiza ekonometrike do të realizohet nëpërmjet një modeli regresi, i cili konsiston në analizën e pesë variabileve vetëm për Bankën Kombëtare Tregtare: ROE, ROA, raportit të kapitalit, madhësisë së bankës dhe raportit të kredive me asetet totale.

Një tjetër qëllim i punimit është të vërtetohet se ROA është matës më i mirë i performancës se ROE, në rastin e BKT. Këtë qëllim punimi e përmbush nëpërmjet analizës së regresit.

Gjatë punimit do të përpiqemi të japim disa evidenca sasiore, për të nxjerrë në pah faktorët që kanë ndikim më të madh në përfitueshmërinë e bankave tregtare në Shqipëri.

Metodologjia e studimit

Metoda e kërkimit do të bazohet mbi variabilet e teorisë së zgjedhur. Paraqitja e të dhënave do të bëhet nëpërmjet tabelave dhe grafikëve, për t'i evidentuar ato. Gjithashtu në punim do të përdoret metoda ekonometrike, e cila bazohet mbi një teori ekzistuese. Të dhënat që nevojiten për kryerjen e studimit do të mblidhen nga baza e të dhënave të Bankës së Shqipërisë dhe Shoqatës Shqiptare të Bankave. Të dhënat e përdorura janë dytësore, por që do të përpunohen për të nxjerrë raportet financiare të marra në studim.

Analiza e të dhënave do të jetë interpretuese, analitike dhe ekonometrike. Fillimisht në punim bëhet rishikimi i literaturës, për të identifikuar faktorët të cilët ndikojnë në performancën e bankave tregtare. Do të realizohet një analizë e detajuar grafike, e cila konsiston në interpretimin e raporteve financiare të marrë në studim dhe analizimin faktorëve që kanë ndikuar në luhatshmërinë e tyre. Ndërsa pjesa e fundit përfshin një analizë empirike për performancën e njëres prej bankave tregtare në Shqipëri, nëpërmjet një analize regresi në EVIEWS.

Hipoteza dhe pyetja kërkimore

Pyetja kryesore kërkimore e ngritur në këtë punim është:

Cili prej matësve ROE apo ROA, është vlerësues më i mirë i performancës financiare të Bankës Kombëtare Tregtare?

Pyetje të tjera kërkimore të studimit janë:

Si kanë ndryshuar norma e mjaftueshmërisë së kapitalit, treguesit e likuiditetit dhe të cilësisë së kredisë për bankën e marrë në studim?

Si janë të korreluara dhe sa është ndikimi i variabileve të marrë në studim në modelin ekonometrik, me ROE-n dhe ROA-n e BKT-s?

Studimi gjithashtu konsiston në vërtetimin e kësaj hipoteze:

“Performanca financiare e matur nga ROA është më e mirë se sa performanca e matur nga ROE, në rastin e Bankës Kombëtare Tregtare.”

Rishikimi i literaturës

Përgjatë kohës autorë të ndryshëm janë munduar të japin përkufizime të ndryshme në lidhje me performancën financiare të një institucioni të caktuar. Kështu sipas Moullin (2003), performanca nënkupton mënyrën se si është menaxhuar firma dhe se si ky menaxhim ka ndikuar tek pronari dhe konsumatorët, në vlerën që ata kanë marrë.

Ndërsa Aktan dhe Bulut (2008), e përkufizojnë performancën financiare si “aftësinë e firmës për të gjeneruar burime të reja prej operacioneve ditore, përgjatë një periudhe kohore të caktuar.”

Darsono dhe Ashari (2005), argumentojnë se performanca financiare vlerëson gjendjen e burimeve të firmës dhe pasqyrat financiare janë tregues të potencialit të burimeve të firmës për të gjeneruar të ardhura.

Studimet e mëparshme kanë një rëndësi të madh në realizimin e një teme të re. Është shumë e rëndësishme të kuptohet se çfarë është thënë në të kaluarën në lidhje me temën e studiuar dhe cilat kanë qenë rezultatet e arritura. Në këtë mënyrë mund të arrihet të bëhen dhe krahasime për të parë nëse studimi ka sjelle një risi në këtë fushë, apo ka pohuar ose mohuar atë që

teoria ka thënë në të kaluarën. Për këtë arsye më poshtë janë paraqitur disa nga teoritë kryesore në lidhje me përfitueshmërinë e bankave tregtare dhe se si ajo ka ndikuar në performancën e këtyre institucioneve.

Në lidhje me performancën e bankave tregtare janë kryer studime të shumta, nga autorë të ndryshëm në të gjithë botën. Ata kanë arritur të shpjegojnë se si ka ndryshuar performanca e bankave të marra në studim përgjatë viteve, cilët kanë qenë faktorët që kanë ndikuar në performancën e tyre, si dhe çfarë e ka karakterizuar secilin vend, cilët kanë qenë specifikat e secilit prej tyre.

Këto studime kanë arritur në përfundime të ndryshme në lidhje me faktorët që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankave tregtare.

Jensen dhe Meckling (1976) arritën në përfundimin se struktura e pronësisë dhe qeverisja e korporatave, kanë ndikim të rëndësishëm në performancën e bankave tregtare. Studimet e tyre shpjegojnë arsyen se pse drejtuesit e institucioneve zgjedhin aktivitete të ndryshme për të rritur performancën e institucionit që ata drejtojnë, duke u bazuar në strukturën e kapitalit të tyre.

Autoriteti Mbikëqyrës i bankave tregtare të çdo vendi, ka si qëllim të minimizojë rrezikun moral, që mund të hasin këto institucione përgjatë veprimtarisë së tyre. Për këto arsye Bankat Qendrore kanë nxjerrë një rregullore, në bazë të të cilës ato i kërkojnë bankave tregtare raporte minimale të kapitalit. Por sipas Saunders dhe Cornett (2008), barra rregullatore neto ndikon negativisht në performancën e bankave tregtare.

Autorë të shumtë arritën në përfundimin se edhe struktura e bilancit ka ndikim të madh mbi përfitueshmërinë e bankave tregtare. Raporti i kapitalit aksioner me asetet totale, si një ndër treguesit më të rëndësishëm të bilancit, mori një vemëndje të veçantë nga këta autorë.

Megjithatë kjo teori hasi dhe kundërshtime. Kështu Modigliani dhe Miller (1958) argumentuan se nuk ekziston asnjë lidhje ndërmjet strukturës së kapitalit, pra nëse firma financohet me kapitalin e vet apo me borxh, me vlerën e tregut të saj. Gjithashtu edhe teoria e risk-kthimit sugjeron se rritja e riskut, duke rritur përdorimin e levës financiare dhe ulur raportin ndërmjet kapitalit dhe asetëve, do të sjellë kthim më të lartë të pritshëm për çdo risk shtesë të marrë, duke rritur kështu edhe përfitueshmërinë e bankave tregtare.

Autorë të ndryshëm si Short (1979), Hu (2002), Goddard (2004), Smirlock (1985) etj, argumentojnë se madhësia e një banke është e lidhur ngushtë me mjaftueshmërinë e kapitalit dhe nga ana tjetër, mjaftueshmëria e kapitalit është e lidhur me përfitueshmërinë e bankës. Sipas tyre bankat e mëdha kanë tendencë të rrisin kapitalin e tyre, duke rritur kështu edhe përfitueshmërinë. Megjithatë studiues të tjerë kanë arritur në përfundimin se madhësia e një banke ndikon pozitivisht në përfitueshmërinë e saj, deri në një nivel të caktuar. Më pas për arsye burokratike, efekti i madhësisë do të ndikojë negativisht në përfitueshmërinë e bankës.

Studime të kryera në vende të ndryshme të Europës arritën në përfundimin se bankat e mirëkapitalizuara kanë më pak mundësi falimentimi dhe kanë performancë më të lartë. Në këtë përfundim arriti dhe Dietrich dhe Wanzenried (2010), gjatë studimit të tyre për bankat tregtare në Zvicër.

Treguesit e likuiditetit si dhe të kredisë, janë përcaktuar si faktorë specifikë bankarë, që ndikojnë në përfitueshmërinë e këtyre institucioneve. Menaxhimi i tyre është i një rëndësie të madhe pasi ndikon drejtpërsëdrejti në menaxhimin e risqeve të ndryshme bankare.

Sipas Bourke (1989), duke qenë se kreditë mbartin një rrezik më të lartë se investimet e tjera, atëherë edhe kthimi i pritur do të jetë edhe më i lartë. Si pasojë marrëdhënia ndërmjet treguesve të likuiditetit dhe performancës do të jetë pozitive.

Gjithashtu Cooper (2003) shpjegon se ndryshimet në riskun e kredisë do të sjellin ndryshime edhe në portofolin e kredive të bankave tregtare, duke ndikuar dhe në përfitueshmërinë e tyre. Sipas tij, një rritje në riskun e kredisë, do të sillte ulje të përfitueshmërisë të bankave tregtare, si pasojë edhe e performancës së tyre.

Në të njëjtin përfundim arritën dhe Miller e Noulas (1997). Sipas tyre institucionet financiare të ekspozuara ndaj një risku të madh kredie dhe sa më i lartë të jetë akumulimi i huave të pakthyera, aq me të vogla do të jenë dhe kthimet. Si pasojë edhe përfitueshmëria do të jetë e ulët.

Edhe menaxhimi i riskut të likuiditetit është i një rëndësie shumë të madhe për veprimtarinë e bankave tregtare. Ka patur studime të ndryshme, që kanë vërtetuar se ekziston një lidhje ndërmjet likuiditetit dhe përfitueshmërisë së bankave tregtare.

Kështu Yuqi Li (2008), në studimin e tij arriti në përfundimin se likuiditeti ka efekt të konsiderueshëm pozitiv ose negativ në përfitueshmërinë e bankave tregtare. Molyneux dhe Thorton (1992) gjejnë një lidhje negative ndërmjet nivelit të likuiditetit dhe përfitueshmërisë së bankave. Pra sipas tij, një rritje e nivelit të likuiditetit sjell ulje të përfitueshmërisë dhe performancës së bankave tregtare. Nga ana tjetër Bourke gjen një lidhje pozitive ndërmjet likuiditetit dhe përfitueshmërisë, pasi sipas tij rritja e nivelit të likuiditetit sjell rritjen e përfitueshmërisë dhe performancës së bankave tregtare.

Gjithashtu studimet kanë treguar se edhe vendimet menaxheriale kanë ndikim të madh në performancën e bankave tregtare. Kështu drejtuesit e niveleve të larta duhet t'i kushtojnë shumë rëndësi vendimeve dhe politikave menaxheriale që ata ndërmarrin. Kryesisht këto vendime kanë të bëjnë me menaxhimin e asetëve dhe detyrimeve të bankës, me menaxhimin e shpenzimeve, me vendimet mbi përqendrimin e portofolit të kredive, etj.

Jensen dhe Meckling (1976) vënë në dukje dhe marrëdhëniet midis pronarëve dhe menaxherëve, si çelës suksesi. Sipas tyre pronari duhet të "forcojë kontrollin" mbi menaxherin, në mënyrë që vendimet e menaxherit të ndikojnë në rritjen e performancës së institucionit për të cilin ai punon.

Literatura argumenton se një ulje e shpenzimeve operative do të rrisë efikasitetin e bankave tregtare, duke ndikuar në rritjen e përfitueshmërisë dhe si pasojë dhe performancës së tyre. Megjithatë më poshtë do të shihet se jo gjithmonë ky arsyetim është i vërtetë.

Wall (1995) arriti në përfundimin se menaxhimi i detyrimeve dhe asetëve të bilancit të një banke ka ndikim të rëndësishëm në nivelin e përfitueshmërisë së saj. Ndërsa Bourke (1989) arriti në përfundimin se shpenzimet e personelit kishin ndikim negativ në ROA-n e bankave, duke ndikuar kështu në uljen e përfitueshmërisë së bankave. Por Molyneux dhe Forbs (1995) e hodhi poshtë këtë teori, duke gjetur një lidhje pozitive ndërmjet shpenzimeve të personelit dhe përfitueshmërisë së bankave tregtare.

Shumë studime kanë arritur në përfundimin se analiza e raporteve financiare është mënyra më e mirë për të matur performancën e bankave tregtare. Gopinathan (2009) në studimin e tij arriti në përfundimin se analiza e raporteve financiare nxjerr në pah mundësitë e firmës për të investuar, mat performancën financiare të firmës dhe analizon bazat e saj. Gjithashtu vihet re se shumë autorë në matjen e performancës së bankave tregtare, por edhe të institucioneve të tjera financiare, përdorin analizën e raporteve financiare.

Kryesisht studiuesit përfitueshmërinë e bankave tregtare e masin nëpërmjet raporteve të performancës si ROE (kthimi nga kapitali i vet) dhe ROA (kthimi nga aktivet). Sipas një hulumtimi të realizuar në Spanjë nga Trujillo (2013), për bankat tregtare të cilat ishin të mirëkapitalizuara, u arrit në përfundimin se bankat tregtare kishin një performancë më të lartë kur përfitueshmëria matej nëpërmjet ROA. Kjo vinte si pasojë e rritjes së kapitalit në raport me asetet totale, pra ROE ulej për shkak të levës financiare.

Analiza e variabileve

Analiza konsiston në studimin e disa indikatorëve kryesorë për BKT, përgjatë një periudhe kohore 6-vjeçare (2008-2013). Analiza do të realizohet nëpërmjet studimit të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, raportit të likuiditetit, cilësisë së kredisë dhe raporteve të përfitueshmërisë (ROE, ROA, ROD).

Përshkrimi i të dhënave

Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit. Të dhënat në lidhje me normën e mjaftueshmërisë së kapitalit, janë të dhëna të gatshme të marra nga raportet vjetore të bankave tregtare.

Raportet e likuiditetit. Dy raportet e likuiditetit që do të përdoren në këtë punim janë si më poshtë: (Kumbirai M. dhe Ëebb R. 2010)

NLTA₁ = Kredi Neto / Aktive Totale

NLDST₂ = Kredi Neto / Depozita Totale

Raporti i parë i likuiditetit mat përqindjen e asetëve të lidhura me kredinë, ndërsa raporti i dytë mat totalin e depozitave të bllokuara në mjete jo-likuide. Sa më e lartë të jetë përqindja e raporteve aq më i ulët është likuiditeti i bankës. **Cilësia e kredisë** paraqet rezervën e humbjeve, si përqindje e totalit të kredive bruto që përbëjnë tërësinë e portofolit të kredive të bankës. Performanca e kredisë vlerëson rreziqet që lidhen me portofolin e kredisë, pra cilësinë e kredive që bankat tregtare lëshojnë për klientët e tyre. Raporti që do të përdoret për të llogaritur cilësinë e kredisë është: (Kumbirai M. dhe Ëebb R. 2010).

LRGL₃ = Rezerva e kredive të humbura / Kredi Bruto

Nëse ky raport do të shënojë rritje do të thotë që kreditë me probleme janë rritur. Pikërisht rritja e kredive me probleme dhe e kredive të këqija, do të ndikojë në përfitueshmërinë e bankave tregtare.

Raportet e përfitueshmërisë (ROE, ROA, ROD) do të përdoren si matës të performancës së bankave tregtare.

Vlera e tyre është e lidhur ngushtë me rezultatin neto të çdo banke tregtare.

Kthimi nga kapitali shpreh kthimin në përqindje për çdo njësi në para të kapitalit të investuar në bankë.

ROE = Fitimi Neto / Asete Totale

Sa më i lartë të jetë ky raport, aq më e lartë do të jetë edhe performanca e bankës tregtare.

Kthimi nga asetet tregon aftësinë e menaxhimit të bankave tregtare, për të tërhequr depozita me kosto të arsyeshme dhe më pas për t'i investuar ato në aktivitete fitimprurëse. ROA tregon se sa mirë janë duke u përdorur aktivet e bankës tregtare për të gjeneruar fitime.

ROA = Fitimi Neto / Aktive Totale

Sa më i lartë të jetë ky raport aq më e lartë është performanca e bankës tregtare.

Kthimi nga depozitat tregon se sa të ardhura neto janë krijuar, për njësi në para të depozitave të hapura në bankë gjatë vitit. Sa më i lartë të jetë ky raport aq më e lartë do të jetë dhe performanca e bankës tregtare.

ROD = Fitimi Neto / Depozita Totale

Net loans to total asset ratio --- Kreditë neto ndaj totalit të asetëve

Net loans to total deposit and borrowing --- Kreditë neto ndaj totalit të depozitave.


Loan loss reserve to gross loan --- Kredi të humbura ndaj kredive bruto.

Zhvlerësimi

Banka Kombëtare Tregtare


Grafiku i mëposhtëm jep të dhëna në lidhje me normën e mjaftueshmërisë së kapitalit të BKT. Viti 2008 tregon normën më të lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit ndërsa viti 2012 normën më të ulët. Megjithatë duket se BKT ka mbajtur normën e mjaftueshmërisë së kapitalit mbi normën e lejuar nga BSH.

GRAFIKU 1. NORMA E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT, BKT.



Burimi: Banka Kombëtare Tregtare, Raporte Vjetore 2008-2013. (Përshtatje të autorit)


GRAFIKU 2. TREGUESIT E LIKUIDITETIT, BKT.



Burimi: Shoqata Shqiptare e Bankave, AAB. Main Financial Indicator of Albanian Banking System 2008-2013. (Llogaritje të autorit)

Nga grafiku duket se të dy treguesit luhaten në të njëjtën formë. Treguesi NLTA rritet deri në vitin 2011 dhe më pas fillon të ulet, duke treguar se likuiditeti i BKT është në rritje. Të njëjtën luhatje ndjek edhe treguesi tjetër, NLDST. Duke qenë se treguesit janë në ulje mund të themi se BKT është një bankë me likuiditet të lartë.

GRAFIKU 3. TREGUESI I CILËSISË SË KREDISË, BKT.



Burimi: Banka Kombëtare Tregtare, Raporte Vjetore 2008-2013. (Llogaritje të autorit)

Nga grafiku duket se treguesi i cilësisë së kredisë LRGL ka një trend rritës. Kjo tregon se për BKT janë rritur kreditë me probleme. Ndryshim përbën viti 2011, i cili shënon një shifër më të ulët se vitet e tjera.


Rritja e kredive me probleme vjen nga rritja e provigjioneve për humbjet nga huatë. Ky fakt shprehet në tabelën e mëposhtme.

TABELA 2. PROVIGJIONET PËR HUMBJET NGA HUATË, BKT.

Viti	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Provigjionet	755,312,874	1,046,603,625	1,217,461,856	1,629,274,661	2,082,685,653	2,737,724,834

Burimi: Banka Kombëtare Tregtare, Raporte Vjetore 2008-2013. (Shprehur në lek)

GRAFIKU 4. PERFORMANCA E BKT.



Burimi: Banka Kombëtare Tregtare, Raporte Vjetore 2008-2013. Shoqata Shqiptare e Bankave AAB, Main Financial Indicator of Albanian Banking System 2008-2013. (Logaritje të autorit)

Performanca e matur nëpërmjet treguesit ROE, paraqitet me thyerje të mëdha. Nga grafiku vihet re se performanca e matur me ROE, në një vit ulet dhe në një tjetër rritet. Ndërsa performanca e matur me ROA dhe ROD shkon pothuajse në të njëjtat vlera. Por në fund të vitit 2013, ndërsa ROE dhe ROA shënojnë ulje në krahasim me vitet e tjera, ROD shënon rritje. Duket se performanca e BKT është në ulje.

Rasti studimor: Banka Kombëtare Tregtare

Gjatë punimit u pa e arsyeshme të studiohet se edhe se cili prej matësve të performancës financiare është më i mirë, në sensin e përmirësimit të saj. Në funksion të kësaj çështjeje lind një pyetje kërkimore: *Cili prej matësve të performancës financiare, vlerëson më mirë përmirësimin e performancës së Bankës Kombëtare Tregtare?*

Dhe **hipoteza** në këtë punim është: **Performanca financiare e matur nga ROE është më e mirë se sa performanca e matur nga ROA, në rastin e Bankës Kombëtare Tregtare.**

Metodologjia e mbledhjes së të dhënave dhe përshkrimi i tyre

Qëllimi i kësaj analize ekonometrike është të studiojë nëse performanca financiare e BKT-së është përmirësuar, duke u matur nga ROE apo ROA. Në fillim është bërë përzgjedhja e modelit ekonometrik që do të përdoret dhe më pas janë mbledhur të gjithë të dhënat e nevojshme, për realizimin e tij. Të dhënat e kërkuara për këtë studim janë marrë nga baza e të dhënave të Shoqatës Shqiptare të Bankave. Të dhënat e siguruar përfshijnë të dhëna tremujore për një periudhë kohore prej gjashtë vitesh, nga viti 2008 deri në vitin 2013. Siç u vu re dhe në hipotezë, studimi do të kryhet vetëm për njëri prej gjashtë bankave të marra në studim, pra për Bankën Kombëtare Tregtare. Arsyeet e zgjedhjes së BKT-së si rast studimor, listohen si më poshtë.

Arsyet e zgjedhjes së BKT për realizimin e modelin ekonometrik.

Banka Kombëtare Tregtare është cilësuar si banka më e mirë e sistemit bankar në Shqipëri. Ky vlerësim vjen nga revista të ndryshme, por edhe agjenci të ndryshme që realizojnë rankimin e bankave. Më poshtë cilësohen disa nga arsyet se pse është përzgjedhur BKT, për realizimin e analizës statistikore.

Në vitin 2015, EMEA Finance jep për BKT për të pestën herë radhazi çmimin si “Banka më e mirë lokale në Shqipëri”. Ky çmim i jepet BKT, në kuadër të arritjeve për sa i takon pjesës së tregut në të gjithë segmentet e biznesit, si edhe në kuadër të performancës së lartë që banka ka patur.

Në vitin 2014 revista The Banker, vlerëson për të pestën herë radhazi BKT si “Banka më e mirë në Shqipëri”. Ky çmim BKT-s i akordohet edhe nga EUROMONEY, një institucion i rëndësishëm ndërkombëtar. JCR Eurasia Rating, një agjenci rankimi japoneze, i akordon BKT-s për të gjashtë herë radhazi notën “AAA (Alb)”, duke treguar se kjo bankë është banka më e qëndrueshme e sistemit bankar në Shqipëri dhe financiarisht më e fortë.

<http://www.bkt.com.al/mbi-bkt.aspx>

Në vitin 2013 JCR Eurasia Rating, vlerëson BKT me notën “BB+”, e cila përfaqëson një notë afatgjatë ndërkombëtare në monedhë të huaj dhe vendase. Gjithashtu JCR-ER, vlerëson BKT me notën “AA”, për Qeverisjen e Korporatës, duke treguar një nivel përputhshmërie me parimet e kodit.

Përshkrimi i të dhënave.

Baza e të dhënave përmban informacion për pesë variabël të marra në studim: ROE, ROA, madhësia e bankës, raporti i kapitalit dhe raporti i kredive. Të dhënat janë marrë nga baza e të dhënave të AAB. Më poshtë bëhet përshkrimi i secilit prej tyre:

Kthimi nga kapitali (ROE) është një indikator i cili do të përdoret për të matur performancën e bankës tregtare. Ky indikator paraqet kthimin për çdo njësi në para të kapitalit që është investuar në bankë. Në këtë analizë, ROE do të përdoret si një variabël i varur.

Kthimi nga asetet (ROA) është një tjetër indikator i cili mat performancën e bankës tregtare. ROA tregon se sa mirë po përdoren aktivet e bankës në mënyrë që të gjenerojnë të ardhura. Edhe ROA do të përdoret si një variabël i varur në këtë analizë.

Madhësia e bankës (SIZE) është në rolin e variabilit të pavarur, i cili matet nga asetet totale të bankës. Roli i tij në analizë është i rëndësishëm pasi ky indikator mat ekonomitë dhe disekonomitë e shkallës. Në mënyrë që ky indikator të përputhet me raportet e tjera të analizës dhe të shmanget efekti shkallë në numra, në analizë do të përdoret *Logaritmi natyror* i madhësisë së bankës.

$$SIZE = LOG \text{ Asete Totale}$$

Raporti i kapitalit (E/TA) zbulon mjaftueshmërinë e kapitalit, duke treguar shëndetin e përgjithshëm financiar, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e bankës. Ky raport tregon aftësinë e bankës për të absorbuar humbjet dhe për të reduktuar ekspozimin ndaj rrezikut të aksionarëve. Edhe ky variabël është në rolin e variabilit të pavarur dhe llogaritet me formulën e mëposhtme:

$$E/TA = \text{Kapitali Total} / \text{Asete Totale}$$

Raporti i kredisë (L/TA) tregon shumën totale të borxhit në raport me asetet që disponon banka. Ky raport njihet ndryshe me raportin e levave dhe sa më i lartë të jetë ai, aq më i lartë është përdorimi i levave dhe aq më i lartë rreziku i lidhur me të. Raporti siguron një masë të burimit të të ardhurave dhe likuiditetit të aktiveve, lidhur me kreditë. Ky raport është përfshirë në analizë si një variabël i pavarur, i cili do të përdoret për të matur ndikimin e kredive në performancën e bankës. Raporti është tregues i likuiditetit të bankës.

$$L/TA = \text{Kredi Totale} / \text{Asete Total}$$

Modeli ekonometrik dhe rezultatet e tij

Për vërtetimin e hipotezës të studimit do të realizohet një model ekonometrik, i cili konsiston në një analizë regresi. Analiza e regresit ka si qëllim të krahasojë dy matësit e performancës financiare të BKT-së dhe të përcaktojë se cili prej tyre tregon përmirësim të performancës së bankës tregtare. Ky fakt do të testohet nëpërmjet koeficientëve përpara çdo indikatorit, duke parë ndikimin e tyre në performancë. Do të studiohet nëse ndikimi i indikatorëve është pozitiv ose negativ në performancë dhe sa njësi është ai. Modeli që do të përdoret në këtë studim bazohet në modelin e përdorur më parë nga Hassan M. dhe Adam M. (2014). Ky model është përzgjedhur për vetë faktin se autori i huaj mat performancën e vetëm një prej bankave tregtare në Irak, pra njëlloj siç do të veprohet në këtë punim.

Ekuacioni bazë, i cili përdoret në çdo model regresi është:

$$Y = \alpha + \beta_1 X_1 + \beta_2 X_2 + \beta_n X_n + \epsilon$$

Ekuacioni shpreh lidhjen që mund të ekzistojë ndërmjet variabilit të varur dhe variabileve të pavarur. ⁷

Ekuacionet që do të përdoren për realizimin e modelit ekonometrik janë dy ekuacionet e mëposhtme:

$$ROE = \alpha + \beta_1 E/TA + \beta_2 SIZE + \beta_3 L/TA + \epsilon$$

$$ROA = \alpha + \beta_1 E/TA + \beta_2 SIZE + \beta_3 L/TA + \epsilon$$

Rezultatet e modelit ekonometrik.

Statistikat përshkuese tregojnë dallimet mesatare ndërmjet variabileve, brenda periudhës së marrë në studim.

Rezultatet e kësaj analize paraqiten në tabelën e mëposhtme.

TABELA 14. STATISTIKAT PËRSHKRUESE TË ANALIZËS

	ROE	ROA	E/TA	SIZE	L/TA
Mean	0.233471	0.014129	0.086089	11.21414	0.355303
Median	0.217450	0.015500	0.074375	11.20578	0.366055

⁷ Një disavantazh ekonomik, siç është një rritje në kosto që vjen nga madhësia e një institucioni.

⁸ shpreh variablin e varur shpreh konstanten α , $\beta_1, \beta_2, \beta_n$ shprehin koeficientët këndor X_1, X_2, X_n shprehin variablat e pavarur shpreh

Maximum	0.570400	0.024800	0.380887	11.43544	0.417262
Minimum	0.048300	0.003400	0.052734	11.00227	0.290197
Std.Dev	0.127373	0.004859	0.063318	0.154198	0.033386
Skeëness	1.195564	-0.397005	4.460928	2.149789	-0.531843
Kurtosis	4.244096	3.260869	21.32735	0.341334	2.670659
Jarque-Bera	7.244096	0.698504	415.4914	2.149789	1.239892
Probability	0.026446	0.705215	0.000000	0.341334	0.537973
Sum	5.603300	0.339100	2.066124	269.1394	8.527280
Sum.Sq.Dev.	0.373151	0.000543	0.092211	0.544570	0.025636
Observations	24	24	24	24	24

Burimi: Të dhënat janë llogaritur nga autori.

Nga të dhënat në tabelë vihet re se mesatarja e variabilit ROE është 20%, ndërkohë që devijimi standard është 12%. Mesatarja e variabilit ROA është 1%, ndërkohë që devijimi standard është 0.4%. Mesatarja e raportit E/TA është 8%, ndërkohë që devijimi standard është 6%. Mesatarja e variabilit SIZE është 1120%, ndërsa devijimi standard është 15%. Mesatarja e variabilit L/TA është 35%, ndërsa devijimi standard është 3%. Nga pjesëtimi i mesatares së çdo variabil me devijimin standard përkatës, del përfundimi se ndërmjet variabileve nuk ekziston një mesatare përshkruese.

Matrica e korrelacionit shërben për të analizuar korrelacionin apo lidhjen që ekziston ndërmjet variabileve të marrë në studim. Rezultatet e kësaj analize paraqiten më poshtë.

TABELA 15. MATRICA E KORRELACIONIT.

	ROE	ROA	E/TA	SIZE	L/TA
ROE	1.000000	0.553023	-0.041382	-0.278397	-0.301217
ROA	0.553023	1.000000	0.172828	0.302317	0.364553
E/TA	-0.041382	0.172828	1.000000	0.284870	0.244016
SIZE	-0.0278397	0.302317	0.284870	1.000000	0.549615
L/TA	-0.301217	0.364553	0.244016	0.549615	1.000000

Burimi: Të dhënat janë llogaritur nga autori.

Nga të dhënat e matricës së korrelacionit vihet re se ndërmjet variabileve ekzistojë lidhje të ndryshme, por jo shumë të rëndësishme. Kështu ndërmjet ROE dhe ROA ekziston një lidhje pozitive, me një normë prej 55%. Ndërsa me të gjithë variabilet e tjerë të pavarur ROE është i lidhur negativisht. Ndërsa ndërmjet variabilit ROA me variabilet e tjerë të pavarur, duket se ekziston një marrëdhënie pozitive.

Përsa i përket lidhjes që ekziston ndërmjet variabileve të pavarur me njëri tjetrin, rezultatet e analizës tregojnë se të tre variabilet janë të korreluar pozitivisht me njëri tjetrin. Lidhjen më të fortë e kanë variabil SIZE me L/TA, të lidhura me një normë prej 54%.

Analiza e regresit është një analizë statistikore e përdorur gjerësisht për matjen e performancës së bankave tregtare. Në këtë studim analiza është përdorur për të testuar marrëdhënien midis variabileve që masin performancën e bankës tregtare dhe raporteve E/TA, L/TA dhe madhësisë së bankës të matur me logaritmin natyror të aseteve. Studimi do të përdorë dy modele për testuar hipotezën e ngritur. Pra, një herë performanca e bankës do të matet me variabilin ROE dhe një herë me variabilin ROA.

Qëllimi i analizës së regresit është përfitimi i ekuacioneve, në mënyrë që të shihet se çfarë ndikimi ka secili variabël i pavarur mbi variabilet e varur. Matja e ndikimit të variabileve të pavarur mbi ROE dhe ROA, do të realizohet nëpërmjet koeficienteve përpara çdo variabili. Rezultatet e analizës së regresit paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Analiza e regresit realizohet vetëm për të parë se si janë koeficientët para çdo variabli të pavarur. Siç do të vihet re nga tabelat e mëposhtme, variablat nuk kanë rëndësi statistikore dhe duke marrë parasysh $\text{Prob}(F\text{-Statistic}) > 0.05$, pranohet H_0 duke treguar se ndërmjet variablave nuk ekziston asnjë lidhje. Megjithatë, vlen të theksohet se rezultatet e kësaj analize janë në përputhje me rezultatet e modelit në të cilin është bazuar. Për më tepër shih: Hassan M. dhe Adam M. (2014).

TABELA 16. REZULTATET E ANALIZËS SË REGRESIT. (VARIABILI I VARUR ROE)

Variable	Coefficient	Std.Error	t-Statistic	Probability
C	2.146785	2.216500	0.968547	0.3443
E/TA	0.125176	0.444738	0.281459	0.7812
SIZE	-0.144966	0.212439	-0.682386	0.5028
L/TA	-0.839916	0.967812	-0.867851	0.3958
R-squared	0.112492	F-statistic	0.845003	-
Adjusted R-sq.	-0.020634	Prob(F-statistic)	0.485383	-

Burimi: Të dhënat janë llogaritur nga autori.

Ekuacioni i cili përftohet nga analiza e regresit është:

$$\text{ROE} = 2.15 + 0.13 \text{ E/TA} - 0.14 \text{ SIZE} - 0.84 \text{ L/TA}$$

Rezultatet e analizës tregojnë se ndërmjet performancës së bankës të matur me ROE dhe raportit të kapitalit E/TA, ekziston një lidhje pozitive. Koefficienti para variabilit E/TA, tregon se një rritje me 1% e E/TA sjell rritjen e ROE me 13%. Ndërsa ndërmjet variabilit SIZE dhe raportit të likuiditetit L/TA me ROE ekziston një lidhje negative, por nga probabiliteti duket se kjo lidhje statistikore nuk është e rëndësishme. Kështu, një rritje me 1% e madhësisë së bankës sjell uljen e ROE me 14%. Ndërsa një rritje me 1% në likuiditetin e bankës të matur me raportin L/TA, sjell uljen e ROE me 84%.

TABELA 17. REZULTATET E ANALIZËS SË REGRESIT. (VARIABILI I VARUR ROA)

Variable	Coefficient	Std.Error	t-Statistic	Probability
C	-0.047102	0.082655	-0.569859	0.5751
E/TA	0.005228	0.016585	0.315232	0.7559
SIZE	0.004149	0.007922	0.523664	0.6063
L/TA	0.040132	0.036091	1.111989	0.2793
R-squared	0.152006	F-Statistic	1.195023	-
Adjusted R-sq	0.024807	Prob(F-statistic)	0.337033	-

Burimi: Të dhënat janë llogaritur nga autori.

Ekuacioni i cili përftohet nga analiza e regresit është:

$$\text{ROA} = -0.05 + 0.005 \text{ E/TA} + 0.004 \text{ SIZE} + 0.04 \text{ L/TA}$$

Sipas analizës së regresit, performanca e bankës e matur me ROA është e lidhur pozitivisht me të tre variabilet e pavarur. Ekuacioni tregon se një rritje me 1% e raportit të kapitalit, sjell rritjen e ROA me 0.5%. Një rritje me 1% e madhësisë së bankës, sjell rritjen e ROA me 0.4%. Ndërsa një rritje me 1% e likuiditetit të bankës të matur me raportin L/TA sjell rritjen e ROA me 4%.

Rezultatet e modelit ekonometrik.

Raporti i kapitalit E/TA, është i lidhur pozitivisht me ROE dhe ROA. Ky rezultat është në përputhje me rezultatet e shumë punimeve të mëparshme si: Dietrich dhe Eänzenried (2010), Ayaudin H., dhe Karakaya A., (2014), etj, por është në kundërshtim me modelin në të cilin është bazuar, Hassan M. dhe Adam M. (2014).

Madhësia e bankës SIZE, është e lidhur negativisht me ROE dhe pozitivisht me ROA. Ky rezultat dëshmohe dhe nga punimi i Javaid S., Anëar J., Zaman K. dhe Ghafoor A. (2011), me ndryshimin se ky punim e mat performancën vetëm me ROA. Ndërsa krahasuar me modelin në të cilin studimi është bazuar, rezultati bie në kundërshtim kur performanca matet me ROE.

Raporti i kredive me asetet L/TA, është i lidhur negativisht me ROE dhe pozitivisht me ROA. Ky rezultat tregon se rritja e kredive do të sjellë uljen e performancës së bankës, të matur me ROE dhe rritjen e performancës së bankës, të matur me ROA.⁹ Në rastin e ROE, përfundimi është në përputhje me rezultatet e studimit të Molyneux dhe Thorton (1992), Gremi E. (2015), si dhe me modelin në të cilin është bazuar studimi. Ndërsa në rastin e ROA, likuiditeti ishte i lidhur pozitivisht me performancën e bankës tregtare. Ky rezultat është në përputhje me studimin e Bourke P. (1989), por në kundërshtim me modelin e bazuar.

⁹Raporti është matës i likuiditetit të bankës dhe tregon efektin që kanë kreditë mbi performancën e BKT. është e rëndësishme të theksohet se kreditë përfshijnë totalin e kredive të bankës dhe jo vetëm kreditë me probleme, prandaj shihet një marrëdhënie pozitive ndërmjet raportit me ROA.

Përfundime

Nëpërmjet një analize regresi, për të parë ndikimin e faktorëve të marrë në studim në performancën e bankave tregtare, të matur me ROE dhe ROA. Analiza arriti në disa përfundime:

Raporti i kapitalit E/TA, është i lidhur pozitivisht me performancën e BKT, të matur si me ROE ashtu edhe me ROA.

Ky rezultat tregon se një bankë e mirëkapitalizuar sjell kthime më të larta, duke ndikuar në rritjen e performancës së saj. Rezultati është tregues i faktit se me më shumë kapital, kthimi i bankës do të jetë më i lartë.

Madhësia e bankës SIZE, është e lidhur negativisht me ROE dhe pozitivisht me ROA. Rezultatet tregojnë se një bankë e cila posedon një sasi të madhe asetesh, jo gjithmonë do të ketë një kthim më të lartë nga kapitali. Ky rezultat dëshmon për faktin se madhësia e bankës ka ndikuar në rritjen e kostove të saj. Ndërsa në rastin e ROA, madhësia e bankës ka ndikim pozitiv mbi performancën e saj. Ky rast dëshmon për faktin se, posedimi i një vlere të lartë asetesh nga banka ndikon në rritjen e kthimit nga aktivet.

Shumë studime kanë arritur në përfundimin se madhësia e një banke ndikon pozitivisht në përfitueshmërinë e saj, por deri në një nivel të caktuar. Më pas për arsye burokratike, efekti i madhësisë do të ndikojë negativisht në përfitueshmërinë e bankës.

Likuiditeti i BKT, i matur nga raporti i kredive me asetet L/TA, është i lidhur negativisht me ROE dhe pozitivisht me ROA. Ky rezultat tregon se rritja e kredive do të sjellë uljen e performancës së bankës, të matur me ROE dhe rritjen e performancës së bankës, të matur me ROA. Kur likuiditeti ndikon negativisht në performancën e bankës, ky është një sinjal për bankën për të qenë më e kujdesshme në dhënien e kredive. Ky rezultat vjen si pasojë e rritjes së humbjeve nga rritja e nivelit të kredive me probleme. Në fakt bankat tregtare në Shqipëri kanë nivele të larta të likuiditetit, por nuk kanë mundësi investimi.

Si përfundim mund të themi se: **“Bazuar në analizën e regresit, ROA është vlerësues më i mirë i performancës, në krahasim me ROE.”** Pra hipoteza e dytë, e ngritur në fillim të analizës, vërtetohet. Qëllimi i studimit ishte të kuptonte se cili prej matësve të performancës do të ndikonte në përmirësimin e saj. Nga analiza rezultoi se ROA ishte e lidhur pozitivisht me të tre variabilet e marrë në studim, duke treguar se rritja e tyre do të rriste dhe performancën. Ndërsa në rastin e ROE, dy prej variabileve ishin të lidhur negativisht duke treguar se rritja e tyre do të zvogëlonte performancën e BKT. Duke u bazuar në këto rezultate, konkludojmë se ROA është matës më i mirë i performancës se sa ROE, në kuptimin se ky matës është tregues më i mirë i përmirësimit të saj.

Bibliografia

- A. Trujillo, “What Determines the Profitability of Banks? Evidence from Spain,” *Accounting & Finance*, Vol. 53, Issue 2, pp. 561-586, 2013.
- A. Dietrich, and G. Wanzenried, “Determinants of bank profitability before and during the crisis: Evidence from Switzerland”, *Journal of International Financial Markets, Institutions and Money*, 2, 307-327, 2011.
- A. Saunders’s, and M. Cornett’s, *Financial Markets & Institutions* 4th ed., McGraw-Hill/Irwin Series in Finance, Insurance and Real Estate, 2008.
- A. Samad, “Bahrain Commercial Bank’s Performance during 1994-2001” *Credit and Financial Management Review* 10(1), (2004). F. Modigliani, and M. H. Miller, “The cost of Capital, corporation finance and the theory of investment,” *American Economic Review*, 48, 261-297, 1958.
- H. Cooper, Editorial. *Psychological Bulletin*, 129, 3-9, 2003.
- I. Ghazouani. B. Ameer, and M. M. Sonia, “Explanatory Factors of Bank Performance in Tunisia: A Panel Model Approach, *Global Journal of Management and Business Research Finance*, Volume 13 Issue 5 Version 1.0, Year 2013.
- M. Adam, “Evaluating the financial performance of banks using financial ratios- a case study of erbil bank for investment and finance,” *European Journal of Accounting Auditing and Finance Research*, Vol.2, No.2, pp. 156-170, August 2014.
- M.C. Jensen, and W. H. Meckling, “Theory of the Firm: Managerial Behavior, Agency Costs and Capital Structure,” *Journal of Financial Economics*, vol. 2, fq. 305 – 360, 1976.
- M. Kumbirai, and R. Webb, “A financial Ratio Analysis of Commercial Bank Performance in South Africa”, *African Review of Economics and Finance*, Vol. 2, No. 1, Dec 2010.
- P. Bourke, “Concentration and other determinants of bank profitability in Europe, North America and Australia”, *Journal of Banking & Finance* 13, 65-79, (1989).
- P. Molyneux, and J. Thornton, “Determinants of European Bank Profitability: A Note”, *Journal of Banking and Finance* 16 (6), 1173- 1178, (1992).
- P. Molyneux, and W. Forbes, “Market structure and performance in European Banking”, *Applied Economics*, 27, 155-159, 1995.
- Q. Kupina, and D. Salko, “Banking system performance on actual stage of economic development (a comparison analysis of banking systems of albania and kosovo),” *MCSER Publishing, Rome-Italy*, Vol 6 No 2 March 2015.
- S. Miller, and A. Noulas, “Portfolio Mix and Large-Bank Profitability in the USA”, *Applied Economics*, 29, 505-512, 1997.
- T. Gopinathan, “Financial ratio analysis for performance check” <http://suite101.com/article/financial-ratio-analysis-for-performance-check-a109025>, 2009.
- T. D. Wall, and P. R. Jackson, *New manufacturing initiatives and shop oor work design*. In A. 1995.
- Yuqi. Li, “Determinants of Banks’ Profitability and its Implication on Risk Management Practices: Panel Evidence from the UK in the Period 1999-2006”, *Dissertation, University of Nottingham*, 2008.

ROLI I FAMILJES NË EDUKIMIN SHËNDETËSOR TË ADOLESHENTIT

MSC. PHD. CANDITAT DRITAN CEKA

Universiteti Europian i Tiranës, Psikologji

ABSTRAKT

Koncepti i adoleshencës, në mënyra të ndryshme, përcaktohet në literaturën psikologjike. Sipas disa autorëve, adoleshenca përfaqëson një periudhë kalimtare nga fëmijëria deri në një pjekuri relative. Disa të tjerë e kuptojnë adoleshencën si një periudhë të pjekurisë seksuale. Në përshtatje me këtë kuptim, problem kryesor i adoleshencës është studimi i ndikimeve biologjike për sjelljen dhe qëndrimin e adoleshentit. Është i madhe numri i Psikologëve, të cilët e përcaktojnë moshën e fillimit dhe mbarimit të adoleshencës. Adoleshentët ndjehen ndryshe nga ç'u ndien si fëmijë dhe ndryshimi ngatërron ata, dhe ata përreth tyre. Ata e dinë se trupat e tyre janë ndryshuar në një mënyrë që nuk është gjithmonë e kënaqshme, perceptojnë se ata janë më të nevrizuar, por, ata nuk janë të qartë në lidhje nga vijnë. Ndikimi i familjes në edukimin shëndetësor të Adoleshentit është faktori kyç. Simbioza është marrëdhënia që kanë dy organizma, të cilët nuk mund të jetojnë pa njëri-tjetrin. Në familjen simbolike disa pjesëtarë, janë nga pjesëtarët e tjerë, e kështu që ata nuk zhvillojnë plotësisht personalitetin e tyre. Llojet e familjeve të mbyllura në edukimin shëndetësor në 100 vitet e fundit, ndikimi i familjes moderne të mbyllur. Çfarë e bën një familje të mirë, të shëndetshme, produktive, sa ndikon familja në rolin e të ushqyerit të adoleshentit, në të fjeturit, në të ushqyerit, si janë marrëdhëniet, mes të adoleshenteve dhe familjes, ndikimi i familjes në parandalimin e drogave tek adoleshentët faktorët kyç? Marrëdhëniet e familjes me adoleshentit që konsumon duhan dhe alkool. Formulimi i një prej cilësive të mësipërme nuk presupozon formimin e njëkohshëm edhe të cilësive të tjera, 14-vjeçari i pjekur fizikisht mund të jetë i papjekur në sferat e tjera. Pikërisht, kjo është një nga veçoritë e adoleshencës.

Fjalë kyç: *marrëdhënie familjare, adoleshentë, familja.*

1. Hyrje

Fjala adoleshent vjen nga latinishtja “adolescere” që do të thotë “rritem ose piqem, maturohem”. Është një etapë e zhvillimit social emocional dhe intelektual, që e zhvendosë të riun drejt të rriturit. Është një periudhë rritje midis fëmijërisë sociale dhe kulturore. Psikologu G. Stanley Hall (1904), së pari, e përshkroi adoleshencën si një fazë të ndryshme të zhvillimit dhe i dha emrin e adoleshencës e saj. Kjo është një periudhë në mes fëmijërisë dhe moshës madhore, dhe është i ndarë në tri faza: e hershme, e mesme dhe të adoleshencës vonë. Hall përshkruan adoleshencën si një periudhë të zhvillimit “stuhi” që çon në tranzicione të pakthyeshme, nga fëmijëria në adoleshencë, drejt moshës madhore. Psikologu G. Stanley Hall thotë, se termi i Adolehencës vjen nga fjala latine *adolescero* dhe se do të thotë të rritet drejt pjekurisë.

Aktualisht ka moskuptime të shumta e diversitet pikëpamjesh midis psikologëve, për kohën e fillimit dhe mbarimit të moshës së adoleshentit. Fillimi dhe fundi i adoleshencës është i ndryshëm jo vetëm në kultura të ndryshme, por edhe në individë të veçantë. Sidoqoftë, është një moshë për të arritur pjekurinë dhe statusin e të rriturit. (Dragoti,2005:12)

Shumica e psikologëve janë të një mendjeje, se adoleshenca fillon në kohën e pubertetit. Për meshkujt, puberteti arrihet afërsisht në moshën 13 vjeçare, ndërsa, për femrat 11 vjeçe. Adolehencia është në kuptimin e vërtetë të fjalës një tranzicion prej varësisë të pavarësia dhe përfundon, kur individi arrin Statusin e të rriturit. Ne do të përshkruajmë shkurt disa nga ndryshimet e rëndësishme të zhvillimit gjatë gjithë hapësirës jetësore të formuluar prej Eriksonit, e cila na ndihmon të kuptojmë, sesi kjo periudhë tranzicioni harmonizohet me zhvillimin e sjelljes njerëzore në përgjithësi. (Terry F,1996:95)

Adolehencia është një periudhë unike në jetën e njeriut, kur faza e një jetë zëvendësohet me një tjetër dhe kjo është faza e moshës së rritur. Një nga detyrat kryesore të adolehencës është ndarja nga prindërit dhe ndërtimi i identitetit, për të cilin njerëzit në atë moshë kanë një nevojë të fortë, sidomos, për përvoja të reja. Adolehentët ndjehen ndryshe nga sa ndjeheshin si fëmijë dhe ndryshimi ngatërron ata dhe ata përreth tyre. Ata e dinë se trupat e tyre janë ndryshuar në një mënyrë që nuk është gjithmonë e kënaqshme, perceptojnë se ata janë më të nevrkosur, por nuk janë të qartë në lidhje me nga vjen kjo.

Pjekuria ose maturimi është ajo gjendje apo moshë e jetës kur personi e komplet zhvillimin e tij fizik, emocional, shpirtëror, social dhe intelektual. Formulimi i një prej cilësive të mësipërme nuk presupozon formimin e njëkohshëm edhe të cilësive të tjera. 14-vjeçari i pjekur fizikisht, mund të jetë i papjekur në sferat e tjera. Pikërisht, kjo është një nga veçoritë e adolehencës.

2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Objektivi i këtij studimi ishte për të analizuar rolin e lidhjeve familjare prindër-adoleshentë, si dhe sjelljet e adoleshentëve karshi dukurive jo të zakonshme, lidhjet e tyre dashurore, rehatinë në familje apo në grupin familjarë, pavarësinë në familje, shqetësimet nga ndryshimet fiziologjike, drogave të ushqyerit jo të rregullt, e shumë e shumë problematika aktuale. Qëllimi i këtij studimi është që të shqyrtojë marrëdhëniet prind-adoleshent, duke identifikuar disa nga faktorët, të cilat deri tani kanë qenë të lëna nga literatura hulumtuese. Konsiderimi i këtyre faktorëve dhe analizimi i aftësisë së tyre për të parashikuar cilësinë e përgjithshme të marrëdhënieve, do të rrisë të kuptuarit tonë të marrëdhënieve dhe të ndihmojë për të dalluar faktorët më të rëndësishëm, nga ata që mund të identifikohen sikur luajnë vetëm një rol periferik në marrëdhënie.

3. Pyetjet kërkimore, hipotezat dhe metodologjia e punimit

Ky punim është një përshkrim i gjendjes aktuale në Republikën e Malit të Zi, me një dizenjim të rastësishëm serish, për miratimin e adoleshentëve dhe familjeve të tyre, si njësi analitike. Studimi kryesisht është kryer në shkollat e mesme në Republikën e Mal të Zi. Janë përdorur intervista në formë pyetësorësh; secili nga adoleshentët ka dhënë përgjigje në mënyrë të pavarur. Pyetjet kanë pasur disa alternativa gjegjëse d.m.th. adoleshentët kanë pasur për të dhënë përgjigje në katrorët e tyre, që kanë qenë të ndërtuar në kuadër të pyetjeve për të dhënë përgjigje. Pyetjet kanë qenë të karakterit familje-adoleshent, kryesisht pyetje që kanë të bëjnë me rehatinë e adoleshentit në familje, shqetësimet fiziologjike që kalon adoleshenti, komunikimet me shoqëri shokë/shoqe, për lidhjet e tyre të dashurisë, në raportet me partnerin, vlera e shprehive të fituara në familje etj.

Adolehencia dhe Familja

Në kushtet e sotme, ku fëmija krijon raporte me institucione të ndryshme, që nga çerdhja, kopshti etj., kërkesat për autonomi duken se shfaqen që në moshë të vogël. Por ajo që bëhet më e theksuar, sidomos gjatë adolehencës është përkushtimi apo kujdesi i familjes ndaj fëmijës së vet adoleshentë. Rrjeti prindër-adoleshent-shoqëri ka vlerë të madhe edukative, por marrëdhëniet ndërmjet palëve duhet të jenë të hapura, të qëndrueshme dhe me mbështetje emotive. Qëndrimi indiferent apo përkujdesja e tepruar nga prindërit, raportet e mbyllura dhe të lëvizshme shoqërore sjellin deformim të personalitetit të adoleshentëve. Ndhima më e madhe që mund t’u jepet të rinjve nga prindërit, është vendosja e raporteve të drejta gjatë dialogut, pa pengesa dhe pa paqartësi të roleve që kanë. Nga niveli i ultë i aftësive gjyquese për të perceptuar veprimet e prindërve, mund të ndodhë që adoleshenti të dalë jashtë kontrollit. Shumë studiues kanë theksuar, se raportet prind-fëmijë në adolehencë modelohen dhe zhvillohen njëkohësisht me vetë vlerat e çdo shoqërie në një moment të saj të caktuar historik. Duhet pranuar,

se familja nuk është i vetmi faktor i shoqërimit të fëmijëve, në procesin e gjatë dhe të mundimshëm të edukimit. Prandaj, është e kuptueshme se raporti prind-fëmijë nuk mund të kuptohet më vetëm me termin e vjetër tradicional të varësisë së të dytëve ndaj të parëve, vartësi që shoqëron fëmijën jo vetëm gjatë moshës së adoleshencës, por, gjër në momentin e daljes nga familja e lindjes, për të formuluar një familje të re dhe për të ndërtuar një jetë të pavarur.

Familja është një sistem dinamik i hapur, në të cilin çdo përfaqësues i saj është i lidhur në mënyrë të pavarur, e shprehur me ndikime të ndryshme dydrejtimëshe. Duke u nisur nga kjo bazë, për të vazhduar më tej në kuptimin e zhvillimit shoqëror, duhet pasur parasysh ndikimi që ushtrojnë prindërit dhe vëllezërit mbi adoleshentin, si dhe ndikimin që kanë ndryshimet, të cilat ndodhin tek adoleshenti në raportet familjare. Sistemi familjar synon të funksionojnë në mënyrë të vazhdueshme e të qëndrueshme, duke tentuar të gjejë baraspesha të reja e forma të larmishme organizative, që i shërbejnë rregullimit sa më normal të familjes, për të gjitha rastet kur lindin kriza të përkohshme apo konflikte të hapura ose të mbyllura. Raportet prindër-adoleshentë nuk janë të njëjta dhe të një forme të prerë. Ato kanë veçoritë e tyre, të cilat varen si nga gjinia e adoleshentit, dhe nga figurat prindërore, nëna apo babai. Dihet se në marrëdhëniet që vendosin, adoleshentët bëjnë dallim ndërmjet nënës e babait, për shkak të veçorive të secilit, kohës që kalojnë, por dhe nga mënyra e komunikimit. Përgjithësisht, në krahasim me baballarët, nënat janë disi më të hapura në trajtimin e problemeve, në ndihmën që ofrojnë, në vlerësimin e ndjenjave. (Kraja, 2008:457)

Atmosfera familjare

Formimi moral s'ka të bëjë vetëm me mësimin formal të vlerave morale, por, sidomos me zhvillimin e qëndrimit të drejtë dhe të pjekurisë emocionale. Prandaj, ndër faktorët familjarë që ndikojnë me përparësi në edukimin e adoleshentëve mund të veçojmë, krijimin e një atmosfere të ngrohtë familjare me një klimë respekti, besimi dhe pranimit të fëmijës ashtu siç është, me anë të pozitive dhe negative që ka, pa i dramatizuar ato, sidomos këto të fundit.

Dukuri të ndryshme negative që janë vërejtur në marrëdhëniet brenda familjes, veçanërisht, në këto vitet e fundit, lidhen edhe me nivelin e lartë të stresit, në përpjekjet për t'iu përshtatur ndryshimeve të vlerave në shoqëri dhe familje. Edhe përpjekjet për përbalimin e konkurrencës në punësim, arsimim, strehim dhe për një jetë më të mirë, në përgjithësi, janë një faktor vendimtar në rritjen dhe akumulimin e problemeve familjare. Ndryshimet politike, shoqërore dhe ekonomike që po ndodhin, po shoqërohen me një rënie të theksuar të nivelit të punës së shkollës, si dhe në uljen e nivelit arsimor të shoqërisë, çka përbën një rrezik tjetër, që dhuna dhe abuzimi në familje të vazhdojë të jenë të pranishme për një kohë të gjatë në jetën tonë të përditshme. Mungesa e arsimit, duke u shoqëruar me mungesën e njohurive për jetën, për familjen, për ligjin, për të drejtat, për mënyrën e komunikimit e të trajtimit të konflikteve, në përgjithësi, mungesa e mundësive për një jetë më të mirë, do të vazhdojë të prodhojë familje mostra, për aq kohë sa të ekzistojnë këto dukuri. Po kështu, pabarazia e theksuar shoqërore apo individualizmi ekstrem i varfërisë, mungesa e burimeve mbështetëse social-ekonomike, mungesa e përgjegjësisë kolektive për nivelin e jetesës, janë faktorët që mbyllin dritën e perspektivës dhe sjellin rënien e perdes së zezë për shumë familje.

Raporti i adoleshentit me institucionet shkollore

Adoleshentët përballen me botën institucionale, ndër të cilat nga më kryesoret për ta është shkolla. Për të arritur integrim me të rriturit, ata orientohen ndaj të gjitha strukturave shoqërore. Në shkollë adoleshentët provojnë, njëkohësisht, raporte të shumëllojshme, të ndryshme, asimetrike në lidhje me pushtetin që ushtrohet mbi ta, i cili vepron një pjesë të madhe të kohës edhe mbi ta, edhe mbi shokët e bashkëmoshatarët të tyre. Raportet zhvillohen brenda një kuadri shkollor, me norma sjellje të ndryshme me ta, të cilat zbatohen në mjedise të tjera. Adoleshenti edukohet që të vlerësojë mësuesin jo vetëm nga moshja, por nga roli që luan në këtë institucion, pra, në shkollë. Mjedisi shkollor është territor i privilegjuar, ku analizohet e zhvillohet procesi shoqëror e mendor i adoleshentit, i cili e ndjek gjatë gjithë jetës së tij. Prandaj kur shkolla nuk funksionon mirë, nuk dëmtohet diçka në aspektin individual, por kryesisht në atë shoqëror, sepse nxiten sisteme sjelljesh jo të dëshiruara.

Detyra e shkollës është që t'i formojë të rinjtë për të përballuar jetën, sepse atyre u duhet të kenë si aftësi shkencore, ashtu dhe të përgatiten me shprehitë e nevojshme për marrëdhëniet shoqërore. Të rinjtë përgjithësisht janë të vetëdijshëm për rëndësinë e shkollës, por një vlerësim dhe përkushtim më të madh për të, tregojnë në mënyrë të veçantë, vajzat. Shpesh, presioni i vazhdueshëm i prindërve për mbarëvajtje në shkollë, shkakton tek adoleshentët shqetësim, ankth, frikë dhe tension. Ata, të cilët nuk shkonin mirë në mësim dhe nuk gjejnë rrugë të besueshme alternative për jetën, rrezikojnë të bien në depresion. Prandaj raportet e nxënësve me shokët, sidomos, me mësuesit luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e tyre psikologjik. Mësuesi përbën për nxënësin një model shoqëror. Prandaj, ai duhet të ketë aftësi relacionale, që të jetë në harmoni të plotë me nxënësit. Vëmendja e mësuesit nuk duhet të përqendrohet vetëm tek disa nxënës të çfarëdo niveli qofshin, por tek të gjithë, pa asnjë dallim. Treguesit i zhvillimit të plotë të të rinjve për jetën nuk është vetëm shkolla. Nxënësit që për motive të ndryshme janë të detyruara të lënë shpejt shkollën, mund ta bazojnë vlerësimin e tyre tek fusha të tjera, si: sporti, muzika, puna etj. Shkolla është një nga institucionet ekstra-familjare, të cilës shoqëria i ka besuar detyrën më të rëndësishme, përgatitjen e të rinjve për jetën shoqërore. Përpara shumë kohësh, në traditën tonë, për vetë kushtet e jetesës në rrethe të mbyllura, kjo ishte vetëm detyrë e familjes, fare pak e rrethit shoqëror. Ndërsa sot, me zhvillimin e gjithanshëm, me hapjen e shoqërisë, shkollës i kërkohet edhe ky rol. Shkolla është mjedisi ku mësohet, këtu realizohet hyrja e në marrëdhënie me të barabartë për të fituar elemente, të cilat i lejojnë të rinjtë të bëhen protagonist të mjedisit kulturor ku ata kanë lindur e rriten. Edhe në pjesën më të madhe të testeve të zhvilluara, shkolla është vlerësuar për rolin e saj në këto drejtime. Ajo mbahet edhe si një nga përvojat

më të vështira për t'u përballuar. Kjo për faktorë që lidhen me familjen, komunitetin dhe vetë nivelin e shkollë. (Kraja,2012:95)

Për më tepër, ndryshimet që ndodhin në adoleshencë, ndikojnë në rezultatet e përvetësimit të njohurive, si dhe në formimin e përgjithshëm.

Kjo ndodh, sepse zhvillimi fiziologjik shoqërohet dhe sjell një cilësi të re të interesave, synimeve, qëllimeve dhe mbi të gjitha, të shkallës së të menduarit. Zhvillimi fizik, psikik dhe shoqëror i të rinjve nuk realizohet në një formë të vetme. Kjo vërtetohet jo vetëm tek të rinj të veçantë, por, sidomos është me e theksuar për gjini të ndryshme. Ekziston një mentalitet i përhapur, sipas të cilit të jesh i suksesshëm në shkollë, do të thotë të kesh rezultate të mira, të jesh inteligjent. Ndërsa, në të kundërtën je një individ që vlen pak ose aspak në familje dhe shoqëri. Ky vlerësim nxirret pa analizuar në thelb shkaqet reale që sjellin në të vërtetë suksesin apo dështimin. Vështirësitë shkollë, përgjithësisht, janë simptoma të një gjendje të shkaktuar nga një përvojë e hidhur shkollë: rendiment i ultë, nivel i ultë i punës së shkollës, vështirësi përshtatje, perceptimi negativ i vetes, që rrjedhin si një ballafaqim me mësuesit dhe me moshatarët, në bazë të aftësisë, shoqërisë, aspektit fizik dhe mjaft faktorëve të tjerë. Vështirësia mund të jetë rrjedhojë e një pozicioni nga një nivel në një tjetër. Këtu flitet për cikle shkollë, por mund të ndodhë edhe në një periudhë më të shkurtër kohore. Cilësi në edukim arrijnë shkollat që krijojnë një klimë pozitive, ku harmonizohen faktorët e brendshëm me faktorët e jashtëm. Komunikimi, bashkëpunimi, fleksibiliteti, besimi, vendimmarrja sa më e gjerë, motivimi, monitorimi dhe vlerësimi janë faktorë bazë.

Marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe adoleshentëve

Adoleshenca shpesh shihet si një periudhë e dobësimit të ndikimit të të rriturve, periudhë kur të rinjtë e distancojnë veten e tyre nga vlera dhe sjelljet e më të moshuarve. Në fakt kur i riu ndihet i vlerësuar nga komuniteti i tij, kur i jepet besim nga mësuesi dhe kur ndihet më i lidhur me të rriturit, ai priret më pak për të abuzuar me drogën, për të braktisur shkollën, për të marrë përsipër rreziqe të panevojshme e kështu me radhë. Prindërit janë shumë të rëndësishëm për mbështetje dhe udhëheqje, por të rritur të tjerët mundet gjithashtu të ndikojnë fuqishëm në zhvillimin e adoleshentit. Marrëdhëniet mbështetëse me të rritur të tjerë, përveç prindërve, konsiderohen si çelës i zhvillimit, që parashikon rezultate pozitive për të. Këta të rritur mundet të jenë të afërmit, mësuesit, drejtuesit fetar, ose, madje edhe prindërit e miqve apo shokët. Të gjithë mund të ndikojnë për pasurimin e rrjetit social, i cili mbështet zhvillimin e shëndetshëm. Marrëdhëniet prind-adoleshent janë shumë të rëndësishme, por ato jo gjithmonë janë të qeta. Debatet lindin kur shtypa e fëmijës për pavarësi përplasat me kontrollin e zakonshëm prindëror. Specifikat varen nga shumë faktor, përfshirë këtu moshën, gjininë dhe kulturën. Konflikti prind-adoleshentë në mënyrë tipike arrijnë kulmin në adoleshencën e hershme, sidomos, mes nënës dhe vajzës. Në përgjithësi, ajo shfaqet si një grindje, diskutime të vogla përsëritëse lidhur me rutinën, që ndodh ditë pas dite, dhe që lidhen me pastërtinë, veshjet, punët e përditshme dhe oraret. (Gjolaj, 2008:212)

Disa grindje mund të jenë tregues të një familjeje të shëndoshë, për arsye se marrëdhëniet e ngushta, gati gjithmonë, përmbajnë disa konflikte. Shumë pak prindër mund t'i rezistojnë komentimit lidhur me çorapet e palara të hedhura në dysheme, ose vathin në vetull dhe pak adoleshentë arrijnë të dëgjojnë të qetë "shprehjen e shqetësimit" pa u ndjerë të gjykuar në mënyrë të padrejtë. Prindërit dëshirojnë që fëmijët e tyre të jenë prezent në dreka familjare dhe në vizita tek të afërmit, ndërkohë që adoleshentët thjeshtë dëshirojnë të jenë pranë miqve të tyre. Pas një periudhe, gjatë së cilës kanë ndodhur grindje të vazhdueshme, në mënyrë tipike shumë prindër përshtaten, duke u dhënë më tepër autonomi. Zakonisht, edhe adoleshentët përshtaten; në moshën 18-vjeçare rritet pjekuria emocionale dhe ulet egocentrizmi. Në lidhje me marrëdhëniet prind-adoleshent është, gjithashtu, e rëndësishme të merren në konsideratë ndryshimet kulturore në pritsmëritë dhe modelet. Në disa kultura, vlera e harmonisë familjare është mbi të tjerat, dhe në këto kultura, zakonisht, të dy brezat i shmangin konfliktet. Kjo gjë mund edhe të jetë sa represive, aq edhe e shëndetshme dhe kjo në varësi të perspektivës kulturore. Mund të ndodhë, që rebelimi i adoleshentit të jetë një strukturë sociale, që supozohet të jetë e nevojshme në kasën e mesme të shoqërive perëndimore. Por kjo nuk ndodh domosdoshmërisht tek këto shoqëri apo edhe tek pozita kulturore ose social-ekonomike të tjera. Afërsia e adoleshentit me familje nuk është vetëm një dimension i marrëdhënieve prind-fëmijë. Një faktor tjetër kyç, i cili mund të ketë një ndikim edhe me të madh në marrëdhënien prind-fëmijë është afërsia, e cila ka katër aspektet specifike.(Po aty)

Puberteti dhe adoleshenca e hershme e periudhës së pubertetit

Shumica e psikologëve janë të një mendjeje: adoleshenca fillon në kohën e pubertetit. Për meshkujt, puberteti arrihet afërsisht në moshën 13 vjeç ndërsa për femra rreth moshës 11 vjeç. Për konceptin e adoleshencës jepen definicione të ndryshme në literaturën profesionale. Psikologët nuk bien dakord për kohën kur mbaron adoleshenca dhe kur fillon moshja e rritur, por, kjo kohë, është zakonisht diku mes moshës 18 dhe 21 vjeç. Sipas disa autorëve, adoleshenca paraqet periudhën kalimtare prej fëmijërisë kah pjekuria relative. Të tjerët, adoleshencën e kuptojnë si kohë të pjekurisë seksuale. Në përputhje me këtë pikëpamje çështja themelore e adoleshencës bëhet studimi i ndikimeve biologjike në sjelljen e të miturve. Studimet më të reja kanë treguar se është posaçërisht i rëndësishëm ndikimi i faktorëve shoqëror në orientimin, formimin e identitetit dhe sjelljen e individëve në këtë moshë. Shumë sjellje të adoleshentëve nuk mund të shpjegohen veçse në sajë të ndikimeve biologjike.

Adoleshenca është në kuptimin e vërtetë të fjalës një tranzicion prej varësisë të pavarësia dhe përfundon, kur individi arrin statusin e të rriturve. Për këto arsye do ta përvetësonim pikëpamjen, se adoleshenca është moshë kalimtare prej fëmijërisë kah pjekuria relative. Dikur, pjekuria seksuale është marr si kriter për pjekurinë e përgjithshme. Te disa popuj, të cilët jetonin ende larg civilizimit dhe nuk i kanë të zhvilluara marrëdhëniet dhe organizimi shoqëror të tipit perëndimor, edhe sot mendohet

ashtu. Kur adoleshenti i tillë e mbërrin pjekurinë seksuale dhe për krijimin e familjes. Sipas autorëve Slloven Toliçiq dhe Smilaniqit, sa më i civilizuar të jetë një popull, aq më tepër zgjatë periudha prej fëmijërisë deri në pjekurinë relative. Te ata më parë arrihet pjekuria seksuale për pjekurinë sociale dhe emocionale, për aftësinë e kryerjes së ndonjë punë ose profesioni të caktuar, si dhe, për qëndrimet jetësore. Për këtë arsye adoleshencën nuk guxojmë ta zëvendësojmë me pubertetin. Puberteti është vetëm pjesë e adoleshencës. Siç e theksuam, adoleshencia si periudhë kalimtare prej fëmijërisë kah pjekuria relative, pos pjekurisë seksuale, përmban edhe karakteristika të tjera të pjekurisë personale, të cilat në shoqërinë bashkëkohore kanë rol gjithnjë e më të rëndësishëm. Këto karakteristika zhvillohen gjatë tërë kësaj periudhe dhe ndikojnë tek njëra-tjetra. Tërë këtë periudhë disa autorë e ndajnë në periudha më të vogla. Si, bie fjala, klasifikimi i psikologes amerikane, E.Karlokut (Karlog), e cila tërë moshën zhvilluese e ndan në tri pjesë:

Para-adoleshencia (përafërsisht prej vitit të dhjetë deri në të dymbëdhjetin).
Adoleshencia e hershme (përafërsisht, prej vitit të trembëdhjetë deri në të gjashtëmbëdhjetin) dhe,
Adoleshencia e vonë (përafërsisht prej vitit të shtatëmbëdhjetë deri në të njëzetin).

Sipas klasifikimit të autorëve tjerë para-adoleshencia do t'i përgjigjet periudhës së para-pubertetit, adoleshencia e hershme periudhës së pubertetit, kurse adoleshencia e vonë periudhës së rinisë. Koha e zgjatjes së këtyre periudhave është vetëm aproksimative dhe nuk vlen për të gjithë individët. Si, bie fjala, disa vajza piqen në pikëpamje seksuale qysh në moshën dymbëdhjetëvjeçare, e disa në atë gjashtëmbëdhjetëvjeçare, kështu që kur të parat gjinden tanimë në adoleshencën e vonë, të tjerat janë ende në adoleshencën e hershme.(Gjolaj, 2008:50)

Vlera e mendimit adoleshent

Të menduarit e adoleshentit pasqyrohet në gjithë rritjen e tij intelektuale, duke krijuar raporte të ndërsjellta me gjithë aspektet e tjera të zhvillimit adoleshent; rritja intelektuale e adoleshentit shpreh interesat dhe veprimtaritë shkollore e jashtëshkollore të tij. Ajo shoqërohet edhe me elementët e vetësimimit e të vetëdukimit, që në këtë moshë marrin një përmbajtje të re. Rritja intelektuale shprehet në mënyrën e përvetësimit të dijeve, në zgjedhim, thellimi dhe zgjerimin e ndjenjave intelektuale, si: kurioziteti, ndjenjat e së resë, e sigurisë në arritjen e rezultatit, e dyshimit në mospësuksin etj. Predispozicioni i zhvilluar intelektual u jep mundësi fëmijëve të kësaj moshe të mos kufizohen vetëm me njohuri që përvetësojnë nga programi mësimorë. Tek libri, adoleshenti, gjen burim të madh e të vazhdueshëm informacioni. Ai lexon tashmë jo vetëm një volum më të madh literature, por e zgjeron më shumë sferën e saj. Vlera reale e të menduarit të adoleshentit nuk mund të kuptohet pa elementet tjerë, shpesh të kundërtën me njëri-tjetrin. Është moshë kur zë të mendojnë rolin e të rriturve. Adoleshenti fillon të largojë inferioritetin fëmijor dhe varësinë nga të rriturit, ai e konsideron vetën si të barabartë, që mund t'i gjykojë ata me reciprocitet të plotë, njëlloj si veten. Ngaqë dëshiron të jetë i rritur, adoleshenti kërkon të zërë vendin e vet në shoqërinë e të rriturve, kryesisht, duke marrë pjesë në idetë, idealet dhe ideologjinë e shoqërisë së rritur me ndërmjetësimin e një sërë simbolesh verbale, ndaj të cilave ka qenë indiferent në fëmijëri. Meqenëse orientohet ndaj botës së të rriturve, pushteti i të menduarit reflektiv të tij, e aftëson të vlerësojë se çfarë mëson ai (Rot,1988:81). Adoleshentët bëhen më të aftë të gjejnë shkaqet morale. Aftësia për të dalluar realen nga e mundshmjia i bën që të vlerësojnë jo vetëm se çfarë bota e të rriturve, por edhe se ç'mund të jetë ajo. Shpesh adoleshenti nuk e bën atë që thotë. Pikërisht dallimi midis së thënës dhe së bërës e vë atë përballë përgjegjësisë së hipokrizisë. Adoleshenti u ankohet prindërve, vetë shkon luan me sendet e tyre. Kur adoleshentët formojnë ndjenjat e identitetit, përqipen shumë të fitojnë më tepër pavarësi. Reagimi i prindërve ndaj kësaj pavarësie përcakton shpesh klimën e marrëdhënieve brenda familjes. Prindërit dhe adoleshentët duhet të mësojnë të përballojnë shqetësimet lidhur me komunikimin, kontrollin, pavarësinë, përgjegjësitë, autoritetin dhe stilet e bashkëveprimit. Disa konflikte brenda familjes duket se janë të paevitueshme. Individët që kanë interesa, personalitete të ngjashme ka të ngjarë të bëhen shokë (Po aty:84).

Adoleshenti, Martesa, Familja dhe problemet

Një pjesë mjaft e madhe e jetës së të rriturit lidhet me familje dhe punë. Ashtu siç ka vënë në dukje Eriksoni, problemi themelor i moshës së rritur të hershme, është intimiteti, me anë të të cilit individi gjen një person tjetër për të jetuar bashkë me të, shpesh në formën e martesës. Vetëm në SHBA 95% e amerikanëve martohet në këtë moshë. Edhe pse martesë zgjidhet nga shumica dërmuese e individëve, është e rëndësishme të kujtojmë, se ka edhe stile të tjera, duke përfshirë këtu të qenurit beqar, bashkëjetesa, priftërinjtë dhe murgeshat e besimit katolik dhe homoseksualët. Në dekadën e tretë të jetës njerëzore fillojnë të rregullojnë raportet seksuale, fillojnë të udhëhiqen nga dashuria dhe shumica, siç e vërejnë në SHBA, martohen. Meshkujt e kësaj periudhe e kanë vajzën e gjetur, ose e ka djalin e gjetur apo mikun. Ata e kalojnë kohën e lirë së bashku, si për argëtim, në shfaqjet e filmit apo dramës, ose shëtitjet apo pushimet verore. Zakonisht, këtyre u thonë ecja e përbashkët. Sepse, ata njohën njëri-tjetrin dhe iu përshtaten njëri-tjetrit, e në fund, vendosin për jetën e përbashkët në martesë. Zakonisht, gjatë kësaj periudhës arrijnë edhe deri te marrëdhëniet seksuale. Por, pikëpamjet e marrëdhënieve seksuale përpara martesës shikohen sipas mjedisit, sepse në mjedisin e krishterë i jepet përparësi përmbajtjes së jetës seksuale përpara martesës, që të mos keqpërdoret dhe shfrytëzohet individi si i tillë, për qëllime të ulëta shfrytëzuese apo eksperimentale. Në disa mjedise është mendësia e marrëdhënieve seksuale përpara martesës, për djem ndryshe dhe për vajza një tjetër kriter, që zakonisht te djemtë tolerohet e te vajzat jo.(Kaza,2006:61)

Komunikimi në familje

Gjatë adoleshencës prindërit dhe fëmijët duhet të mësohen të vendosin format e reja të mara dhe ndër-reciproke. Prindërit duhet të jenë të aftë të njohin dhe të nxisin kërkesat e adoleshentëve për të fituar një pavarësi më të madhe, në përputhje me moshën. Të rinjtë kanë nevojë të kenë një liri të mjaftueshme për t'u shprehur, si individë që kanë kërkesa dhe ndjenjat e veta, që janë të aftë të marrin vendime të rëndësishme për jetën, si dhe marrin përgjegjësi për vendimet dhe pasojat e tyre.

Kërkimet e fundit të bëra mbi familje normale tregojnë, se atje ku ka komunikim të mirë mes prindërve dhe fëmijëve vihen re dhe nivele të mira të kohezionit familjar, të përshtatjes dhe kënaqësisë. Në fakt, një komunikim i mirë zhvillon një rol të rëndësishëm që ndihmon anëtarët e familjes të gjejnë një ekuilibër të drejtë, midis kërkesës për t'u sjellë si individ të ndarë dhe kërkesë për të mbajtur lidhje reciproke. Po ashtu, një komunikim i mirë në familje favorizon në adoleshencë formimin e identitetit dhe fitimin e roleve. Në të kundërtën, kërkimet e bëra në familje me probleme, me prindër të ndarë etj., tregojnë se shpesh midis tyre nuk gjendet gjuha e një komunikimi efikas. Moshatarët luajnë një rol të madh në zhvillimin psikologjik e social dhe fetar të pjesës më të madhe të adoleshentëve. Roli i moshatarëve është, veçanërisht, në periudhën e pubertetit. (Hoxha @ Xhakollari,2010:169)

Në fakt, në këtë periudhë raportet me moshatarët krijojnë detyrën e prototipave të raporteve të ardhshme të të rriturve, të punës dhe të bashkëveprimeve me persona të gjinisë tjetër. Nuk duhet të harrohet se adoleshentët, thjeshtë, dobësojnë lidhjet e tyre me prindërit, progresivisht, duke iu ofruar më tepër pavarësisë. Përkundrazi, raportet me familjarët tentojnë shpesh të karakterizohen nga emocione konfliktuale, në vitet e para të adoleshencës, dëshirat e varësisë vazhdojnë të qëndrojnë pranë aspirimit për pavarësi, armiqësia përzihet me dashurinë dhe shfaqen konfliktet rreth vlerave dhe sjelljeve sociale. Adoleshenti ndihet më mirë me një mike, sesa me prindërit dhe këtu ata ndjehen vetvetja, po kështu në jetën e përditshme mëson më shumë nga një mik, sesa nga prindërit. Adoleshencia në përgjithësi, është një periudhë që karakterizohet si nga dëshira intensive për shoqëri, ashtu dhe nga një ndjenjë e shpesh të e vetmisë. Si rrjedhim, fakti i pranimit nga moshatarët, sidomos, nga një ose më shumë miq është shumë domethënës në jetën e një të riu.

Familja - për të tërhequr më shumë interesin e të rinjve, pyetësi u mendua ta shihte fushën e përmbajtjes në të gjitha problemet e moshës së adoleshencës. Në përfundim të tij, në bazë të përgjigjeve të dhëna, u bë e mundur të kemi një material të pasur, një pjesë të të cilit po e paraqes në vazhdim.


4. Analizë, interpretimi të dhënash

Siç shihet edhe në grafikun që është paraqitur tek pyetja: se sa ndjehen të lirë për të vepruar, 17% e adoleshentëve të anketuar u shprehën, se janë plotësisht të lirë të dalin me shokë ose shoqe, 9% janë të lirë të dërgojnë letra dhe mesazhe, këtu përfshinin mesazhet telefonike, email kompjuterikë, mesazhe nga rrjetet sociale facebook, tweter etj., 17% janë të lirë të zgjedhin dëfrimet dhe shoqërinë dhe 57% e tyre janë të lirë të zgjedhin studimet dhe profesionet që dëshirojnë. Siç shihet, sipas të dhënave të fituara nga hulumtimi, shumica dërmuese e adoleshentëve janë të lirë të zgjedhin drejtimin apo profesionin e tyre që dëshirojnë, pa ndikuar familja në to, po ashtu shihet qartë se 9% e të rinjve janë të lirë për të dërguar mesazhe, qofshin ato telefonike apo email, apo rrjet sociale facebook apo twitter etj. Po ashtu, shihet se 17% për qind kemi të bëjmë, sa i përket kur është pyetja për dëfrimet e tyre me shoqërinë etj. Siç shihet qartë, familja nuk është ajo që i ndalon adoleshentët, qofshin për të studiuar, qofshin për t'u argëtuar, apo qoftë edhe për të komunikuar me shokun apo shoqen e tyre.



Tek pyetja lidhur me ndryshimet fiziologjike që pësojnë adoleshentët, përgjigjet mblidhen kështu: a) 43% nuk ndihen aspak të shqetësuar, b) 41% ndihen pak të shqetësuar, c) 13% ndihen shumë të shqetësuar dhe d) 3% nuk pranojnë të përgjigjen fare apo nuk dëshirojnë. Shihet se një numër fort i madh i adoleshentëve të anketuar nuk ndihen aspak të


shqetësuar për ndryshimet fiziologjike që përjetojnë, ndërsa, po ashtu, edhe një grup tjetër bukur i madh ndihen, deri diku, të shqetësuar apo, thënë drejt, ata ndihen dhe kanë frikë ta shprehin direkt në opinion, realitetin e tyre, ndërsa një grup i vogël e shohin veten të frikësuar, në proceset fiziologjike që pëson adoleshenti me ndryshimet fiziologjike.




Në lidhje me pyetjen, se sa jeni të lirë të komunikoni me shoqërinë, kemi këto të dhëna në pyetjen e parë a) 10% e adoleshentëve të anketuar deklarojnë, se komunikojnë normalisht me shoqëri, b) 20% komunikojnë normalisht me shokë, po ashtu të njëjtin rezultat kemi edhe me gjininë femërore c) 20% e tyre komunikojnë edhe me shoqe, d) po ashtu 20% e tyre komunikojnë më nënën, ndërsa, kemi një rezultat pak me të ulët, sa i përket komunikimit me d) Babain vetëm 10% komunikon; f) ndërsa me motrën komunikojnë 11% e) me vëllain komunikojnë vetëm 7%, ndërsa 2% e adoleshentëve të anketuar nuk komunikon fare. Siç duken rezultatet e fituara nga anketimi me adoleshentët, shihet qartë se më së shumti, adoleshentët janë të lidhur me nënën e tyre, por edhe me shoqërinë, shokë dhe shoqe kryesisht, me babain dhe motrën janë diçka me pak të lidhur, si dhe me vëllanë. Sot të rinjtë janë kryesisht të lidhur me shoqëri sesa me anëtarët e familjes, dhe familja këtu nuk është ajo që duhet të ketë rolin primar, sepse shumë nga adoleshentët del që nuk janë të lidhur drejtpërsëdrejti me familjen, sesa shokëve.




Te pyetja, se a janë në lidhje dashurie adoleshentët, apo a keni një të dashur, kemi këto rezultate: a) jo nuk kemi të dashur janë deklaruar 60% e adoleshentëve; b) po janë deklaruar 38% e adoleshentëve të anketuar, ndërsa 2% nuk kam pranuar t'i përgjigjen kësaj pyetje. Nga kjo që shihet në tabelë del, se pjesa dërmuese e adoleshentëve nuk kanë të dashur, por është edhe një pjesë tjetër që ka të dashur. Pak a shumë, shihet një lidhje mes adoleshentëve; kjo pothuaj është në masa normale, duke pasur parasysh të thënat në Bashkimin Europian.



Nga pyetja në lidhje me raportet dashurore mes adoleshentëve, kemi këto rezultate të fituara: a)56% tregojnë se diskutojnë me shoqërinë e tyre, 17% deklarojnë që komunikojnë me familjen e tyre, 23% nuk diskutojnë fare, po ashtu, 3% nuk dëshirojnë të japin përgjigje, ndërsa vetëm 1% e adoleshentëve të anketuar diskutojnë me mësuesin. Nga të dhënat që kemi marrë del, se adoleshentët më lehtë e kanë t'i diskutojnë lidhjet e tyre me shoqërinë kryesisht, me shokë apo shoqe, para se t'i diskutojnë me familjen e tyre; d.m.th. këto bëjnë njëfarë parapërgatitje: para se ata t'i diskutojnë problematikat në lidhje me raportet dashurore me familjen, bisedojnë apo dokordohen me shoqëri, por është edhe tipi i adoleshentëve të mbyllur, ku shihet qartë se janë jo pak, por 23% e të anketuarve, që nuk dëshirojnë aspak të flasin për lidhjet e tyre dashurore as me shoqërinë, as me familjen, por as me mësuesin.



pyetjes, sa vlejën për jetën shprehinë dhe vlerat e fituara në familje dhe në shkollë, a) 16% e të anketuarve u shprehën se janë të pamjaftueshme, b) 81% shprehen se janë të mjaftueshme, c) 1% thonë se janë të pamjaftueshme, dhe po ashtu d)1% nuk dhanë përgjigje. Siç del edhe nga sa përmendëm më sipër, adoleshentët shprehen me rezerva dhe kjo është e natyrshme. Por, duke marrë parasysh përqindjet me luhatje, pasaktësinë, fiktivitetin etj., pritjet themelore të zhvillimit të kësaj moshe janë të qarta. Shihet mirë, që adoleshentët theksojnë se vlejën shprehinë dhe vlerat e fituara në familje dhe shkollë, ndërsa një numër i vogël, për të mos thënë hiç, tregojnë se nuk janë fare të pamjaftueshme, dhe një përqindje jo e vogël e adoleshentëve tregojnë, se janë të pamjaftueshme shprehinë dhe vlerat e fituara.



5. Konkluzione/Rekomandime

Siç del edhe nga sa përmendëm më sipër, adoleshentët shprehen me rezerva, dhe kjo është e natyrshme. Por, duke marrë parasysh përqindjet me luhate të vogël, prirjet themelore të zhvillimit të kësaj moshe janë të qarta. Sikur t'i analizojmë përgjigjet me vëmendje, mund të themi se shumë të rinj janë të lirë për të vepruar, por, siç duan dhe kërkojnë prindërit e tyre. Këtu varet se me ç'prindër kemi të bëjmë, ç'nivel mentaliteti kanë, për të zbuluar se çfarë modeli kërkojë të realizojnë etj. Ndryshimet në adoleshencë janë të mëdha, asnjëri prej tyre nuk ndihet si më parë. Ky proces që ndodh shkakton situata frike, kureshtje e misteri për të ardhmen. Shpesh ndodhin gjëra që nuk di si t'i shpjegojmë. Prandaj në mungesë të një njeriu të aftë për konsultime, fillon mbyllja e adoleshentit në vetvete. Së bashku me ndryshimet fiziologjike, të rinjtë përfshihen në tërheqjet seksuale. Por, në këtë fushë janë më të mistershëm, revoltohen të shprehen me shokët e shoqet e tyre dhe e kanë gati të ndaluar të komunikojnë me më të rritur. Njohuritë që marrim për këto probleme në familje dhe në shkollë janë të kufizuara, ndonëse në realitet gjërat rrjedhin e ndodhin krejt ndryshe. Të rinjtë e vlerësojnë rolin e familjes dhe të shkollës, ata e vlerësojnë këto dy institucione si faktor bazë për t'u futur në shtëpinë apo në rrugët e jetës, por si funksionojnë e ç'rol luajnë në të vërtetë këta faktorë, duhen parë e duhen vlerësuar me vëmendje mendimet e nxënësve. Zhvillimi fiziologjik shkakton probleme të mëdha dhe, veçanërisht, përjetimet e gjinive të ndryshme kanë intensitet jo të njëjtë. Disa nga këto ndryshime janë jo vetëm të papritura, por edhe të pashpjegueshme për të rinjtë, gjë e cila mund të shkaktojë edhe alarm. Në përgjigje lexohet qartë, se informacioni, që marrim në shkollë dhe në familje është i kufizuar, e shpesh në disa raste, edhe i pa organizuar. Mbajtja larg e këtyre dukurive për t'i ruajtur sa më shumë të rinjtë, është shqetësuese, sepse është e ngritur gati në sistemin e edukimit. Familja është ajo që duhet të luaj rolin kryesor në edukimin e fëmijës së vet e, në veçanti, të kujdeset në periudhën e adoleshencës, sepse, edhe adoleshenti e sheh vetën të mbrojtur tek familja e tij në periudhën e më problematike që ai është duke kaluar, e ajo është periudha e zhvillimeve të mëdha dhe të shpeshta, që quhet adoleshencë.

Bibliografia

- Buzan, Tony, (2006), *Truri i fëmijës*, Tiranë.
- Bratistic Zorec, M. (2006), *Teorije u Razvoj psihologiji*, Ljubljana
- Chavez, Martha Alicia (2002), *Fëmija-Pasqyra jote*, Tiranë.
- Dolto, Fransuazë, (2003) *Adoleshenca*, 2013. Tiranë.
- Dolto, Françoise (2013), *Fjalë për Adoleshentët*, Tiranë.
- Shehu, Artimisi, (2007) *Psikopatologjia e fëmijërisë dhe Adoleshencës*.
- Dragoti, Edmond(2005) *Adoleshenti*, Tiranë.
- Kraja, Musa (2008) *Sa merresh me fëmijën tënd*, Tiranë.
- Kraja, Musa (2012) *Pedagogjia*, Tiranë
- Hoxha, Mit'hat dhe Xh. Ledian, *Psikologjia e Zhvillimit gjatë gjithë jetës*, Tiranë, 2010.
- Nosh Dom Gjolaj, *Psikologjia Zhvillimore*, Shkodër, 2008
- Pettijohn. Terry F (1996) *Psikologjia*, Tiranë.
- Pellai. Alberto (2013) *Këshilla për Adoleshentët*, 2013.Tiranë.
- Marinesku, Aurelia (2002), *Kodi i sjelljeve të pëlqyeshme sot*, Tiranë
- Rot Nikolla (1968) *Psikologjia e Përgjithshme*, Prishtinë
- Pajazit Nushi (2001) *Psikologjia*, Prishtinë
- Pajazit Nushi (1999) *Psikologjia e përgjithshme*, Prishtinë.
- Deva, Aferdita, *Puberteti dhe Adoleshenca*, Shkëndija, nr.12, Prishtinë
- Kaza, Ndue (2006) *Adoleshenca stina e shpërthimeve* Tiranë.
- Trebjeshanin Zarko dhe Zoran Llallovic,(2008) *Psikologjia*, Podgoricë.
- Ross Vasta, Marshall M.Haith, Scott A.Miller, (2009), *Psikologjia e Fëmijës*, Tiranë.
- Strang, R.(1957), "The Adolescent Views Himself " Nevv York, Mc Grav-Hill.
- Richardson, J.E and Forrester, J.F.(1951), *Studies in the Social Psychology of Adolescence*, London
- Zhurda Ylli (2009) *Psikologjia*, Tiranë

E DREJTA E PRONËSISË, SI NJË NGA TË DREJTAT THEMELORE KUSHTETUESE. MBROJTJA JURIDIKO-LIGJORE E SAJ. RASTI I SHQIPËRISË

SOFIANA VELIU

ABSTRAKT

Tema e përzgjedhur ka për qëllim të evidentojë disa nga çështjet aktuale në lidhje me të drejtën e pronës, si një nga të drejtat themelore të individit. Edhe pse në Kushtetutën shqiptare ekzistojnë parashikimet dhe garancitë për të drejtën mbi pronësinë, problemi qëndron në efektivitetin praktik të këtyre rregullimeve, të titujve ekzekutivë të pronësisë nga instrumentet shtetërorë dhe zhdëmtimet paraprake në rastin e heqjes së kësaj të drejte. Për pasojë, situata e deritanishme tregon qartë se, ka ende mbivendosje të titujve të pronësisë dhe shumë pak mbrojtje juridike, sepse veprimi i shitblerjes mbetet informal nga këndvështrimi i ligjit. Në analizën e vendimeve të GJEDNJ-së me palë Shqipërinë dhe rekomandimeve të KE, në disa raste ligji dhe praktika e gjykatave shqiptare bien ndesh me standardet ndërkombëtare në disa drejtime, duke shkaktuar “ngërç” mes standardeve europiane dhe kulturës juridike shqiptare. Në kuadër të respektimit dhe garantimit të të drejtave themelore, kërkohet një angazhim më i madh për të plotësuar dhe konsoliduar sistemin e të drejtave të pronësisë në tërësi dhe mos cenimin e thelbit të këtyre të drejtave. Konsolidimi i së drejtës së pronësisë dhe garantimi i saj, lidhet ngushtë me konsolidimin e shtetit demokratik në tërësi.

E drejta e pronës

Të drejtën e pronësisë në legjislacionin shqiptar e gjejmë të sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila hyri në fuqi në datën 28.11. 1998.

Në Nenin 11 të saj gjejmë të shprehur: *“Sistemi ekonomik në Republikën e Shqipërisë bazohet në pronën private, publike si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. Prona private dhe publike mbrohen njëjloj me ligj. “Kushtetuta e Shqipërisë” e trajton çështjen pronës private në nenin 41 që përmban:*

- 1- E drejta e pronës private është e garantuar
- 2- Prona private fitohet me dhurim, me trashëgim, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.
- 3- Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publike.
- 4- Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.
- 5- Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

Në tërësinë e saj kjo dispozitë sanksionon njohjen, ruajtjen dhe garantimin e pronës private nga cilido qoftë. Sipas saj, çdo individ në Republikën e Shqipërisë ka të drejtën e pronës private dhe shteti merr të gjitha masat për të garantuar mbrojtjen e saj .

Detyrimet që burojnë nga e drejta e pronës e sanksionuara në nenin 1 Protokollit 1 të KEDNJ dhe nenin 41 të Kushtetutës të vendit tonë, zërthehen në disa drejtime dhe konkretisht në:

- 1 - Detyrimi për respektimin e së drejtës së pronësisë.**
- 2- Detyrimi për mbrojtjen e saj.**
- 3- Detyrimi për realizimin e kësaj të drejte.**

1-Me respektim të së drejtës së pronësisë, kuptojmë detyrimin e shtetit për të mos ndërhyrë në të drejtat e pronësisë së një individi apo të një kolektivi individësh, qofshin këta të organizuar edhe në shoqëri juridike, shoqata, fundacione etj.

2-me mbrojtje të së drejtës së pronësisë, kuptojmë detyrimin e shtetit për mbrojtjen e pronës së personit fizik apo juridik nga ndërhyrjet e të tretëve. Të tillë mund të përmendim vjedhësit.

3-me detyrimin për realizimin e së drejtës së pronësisë do të kuptojmë detyrimin e shtetit për të krijuar të gjitha kushtet që e drejta e pronësisë nga një e drejtë potenciale të ekzistojë si e drejtë reale.

Për të parë në ç’raport qëndron shteti shqiptar me detyrimet që përcakton Neni 1 Protokollit 1 për çdo ratifikues të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, hedhim vështrimin nga legjislacioni shqiptar.

Një çështje që lidhet me dy dispozitat si me Nenin 1 të Protokollit 1 dhe me dispozitën kushtetuese (neni41), është se çfarë do të kuptojmë me *pasuri*.

Sipas Nenit 1 të Protokollit 1, pasuri është gjithçka që përcaktohet si e drejtë pasurore në sistemet kombëtare.

Ky problem gjen një zbrërthim të saktë në paragrafin e dytë të nenit 41 që i referohet Kodit Civil. Është ky i fundit që shtjellon kuptimin e pronës, përmbajtjen e pronësisë, llojet e pronës. Madje me anë të këtij referimi, kjo dispozitë kushtetuese ka përcaktuar dhe mënyrat e fitimit të pronësisë që i disiplinon rreptësisht ligji material civil (Kodi Civil). Sipas saj, pronësia mund të fitohet vetëm me mënyrat e parashikuara dhe rregulluara me ligj.

Nga kjo rrjedh konkluzioni logjik që, vetëm prona e përfutur në mënyrë të ligjshme gëzon mbrojtje kushtetuese dhe ligjore. Mirëpo duke u nisur nga neni 17/2 i Kushtetutës shqiptare dhe nga qëndrimi i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen ONERYILDIZ kundër TURQISË, lind natyrshëm mendimi se edhe ato prona që përfutohen në mënyrë të paligjshme, por që janë lejuar për një periudhë kohe, mund të përfutojnë mbrojtje nga ana e Nenit 1 Protokollit 1 i Konventës Europiane e të Drejtave të Njeriut. E meqë kufizimet e të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutën shqiptare, nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, edhe në realitetin shqiptar prona e përfutur në mënyrë të paligjshme(p.sh ndërtimet e paligjshme të bëra gjatë dhjetëvjeçarit të fundit), mund të gëzojë mbrojtje kushtetuese dhe ligjore . Por praktika gjyqësore shqiptare duket se mban një qëndrim të ndryshëm nga ky qëndrim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Do t’i referohem vendimit unifikues nr.22 datë 13. 3.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë veçoj: *“Palët në proces kanë qenë bashkëshortë. Ata kanë patur në bashkëpronësi një apartament banimi që rezulton pronë e regjistruar në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme. Ngjitur me apartamentin ekzistues, pa lejen e organit kompetent shtetëror, kanë lejuar ndërtimin e një shtese, pjesëtimin e së cilës kërkon paditësja gjyqësisht. Meqenëse ky ndërtim është i paligjshëm, ai nuk është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Me pretendimin për pjesëtim të sendit në bashkëpronësi, paditësja, duhet të provojë që ajo dhe pjesëmarrësit e tjerë në proces kanë të drejta mbi sendin që mund të ndahen. Kuptimi i pronësisë është i lidhur me përcaktimin ligjor dhe kjo del nga përmbajtja e nenit 149 të Kodit Civil **Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet brenda kufijve të ligjit. E drejta e pronësisë fitohet sipas mënyrave të përcaktuara në K.C dhe ligje të tjera**”. Paditësja nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar pretendimin e saj të pronësisë ose të kalimit të sendit të bashkëpronësi. Meqenëse ky ndërtim është i paligjshëm nuk mund të provohet se nga ai mund të burojnë interesa të ligjshme. Nuk mund të pranohet se nga një ndërtim i tillë burojnë të drejta bashkëpronësie për*

sa kohë që e drejta e pronësisë nuk është fituar në mënyrë të ligjshme. Gjykata, është organ që në vendimin e saj bazohet në ligj, pra në funksion të ligjit shqyrton veprimin e njëres apo tjetrës palë. Për sa më sipër Gjykata e Lartë arrin në bindjen se: ...shtesa ose ndërtimi i cili është realizuar në kundërshtim me normat në fuqi nuk mund të jetë objekt i pjesëtimit gjyqësor dhe personi i interesuar për arsye se nuk përfaqëson një interes të ligjshëm, nuk mund të legjitimohet në ngritjen e padisë me objekt pjesëtimit e pasurisë.

I parë në një këndvështrim më të gjerë, ky vendim na çon në konkluzionin se, prona e përfutur në mënyrë të paligjshme nuk gëzon mbrojtje ligjore në sistemin ligjor shqiptar. Përkundrazi për të unifikuar legjislacionin e vendit tonë ne frymën e nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ si dhe të vetë praktikës gjyqësore të GJEDNJ, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar kuadrin ligjor për legalizimin e ndërtimeve dhe shtesave të paligjshme duke i dhënë në këtë mënyrë vlerë në aspektin juridik atij realiteti social që ekziston sot në vendin tonë në fushën e ndërtimeve. Gjithsesi ky kuadër ligjor nuk ndjek të njëjtat kritere mbrojtje për sa i përket pronarëve ekzistues (privatë ose shtetërorë) të cilët e humbasin pronësinë mbi truallin ose tokën e tyre bujqësore për shkak të ndërtimeve pa leje, sepse shpërblyeri që ata marrin, nuk plotëson të njëjtat standarde me ato të një shpërblyeri të drejtë që kërkon neni 41/3 i Kushtetutës si dhe neni 1 i Protokollit 1. Në rastet kur i referohemi legalizimit të ndërtimeve pa leje, përballë njëri-tjetrit kemi dy grupime me interesa të kundërta në çështjet e pronësisë: nga njëra anë **zotëruesit e paligjshëm të tokës** dhe nga ana tjetër, **pronarët e ligjshëm** të saj. Është e vështirë të peshosh interesin publik në favor të grupimit të parë. Të dy subjektet janë subjekte privatë. Sidoqoftë, pozita juridike e të dytës është shumë më e favorshme se e të parës, për arsye se është pronari legjitim i pronës, në dallim nga tjetri që është posedues jo legjitim apo me keqbesim i pronës. Ndërhyrja e shtetit duhet të ketë për qëllim gjetjen e balancës të dy ose më shumë interesave që ndërthuren me njëra-tjetrën. Nga analiza që i bëhet çështjes në shqyrtim, konstatohet se ligjvënësi nuk ka vendosur në ekuilibër të drejtë interesat e pronarëve të ligjshëm që nuk kanë shkelur ligjin, me interesat e atyre që kanë zaptuar dhe ndërtuar në mënyrë të paligjshme. Disproporcioni ndërmjet pronarëve të ligjshëm dhe personave që kanë ndërtuar pa leje konstatohet në mënyrën se si të dyja palët e fitojnë dhe e humbasin pronësinë, në vlerën e çmimit të tokës, si dhe në kohën e përfutimit të të drejtave respektive prej tyre. Ligji e ka zgjeruar në mënyrë abuzive dhe në dëm të pronarëve të ligjshëm rrethin e subjekteve përfutuese, duke përfshirë në këtë kategori krahas objekteve për funksione strehimi dhe ato ku ushtrohet veprimtari ekonomike. Një rregullim i tillë e komprometon ekzistencën e interesit publik me qëllim promovimin e drejtësisë sociale, në kufizimin që i bëhet të drejtës së pronës. Neni 15 i ligjit i jep përparësi zhveshjes nga pronësia të pronarit të ligjshëm, pa e shpërblyer në mënyrë të menjëhershme. Ndërsa subjektit që ka ndërtuar pa leje i njeh në mënyrë të menjëhershme pronësinë mbi truallin, kundërt një çmimi tepër simbolik.

Nga sa trajtuam më sipër shihet se është shumë e rëndësishme që kuadri ligjor në Republikën e Shqipërisë që ka të bëjë me shpronësimet, duhet të respektojë dispozitat e nenit 41 të Kushtetutës si dhe të vetë nenin 1 Protokollit 1.

Përveç nenit 41 që i kushtohet pronës private, neni 42 e vë të drejtën e pronës ndër të drejtat themelore të njohura me kushtetutë e me ligj. Sipas nenit 42 të Kushtetutës prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor. Dhe është pikërisht ky paragraf që na referon tek neni 6 i Konventës Europiane e të Drejtave të Njeriut, i cili bën fjalë për një proces të rregullt ligjor duke ofruar brenda tij të gjitha garancitë e duhura procedurale për t'i siguruar qytetarëve mbrojtje efektive të të drejtave dhe lirive të tyre, ku një e drejtë e tillë themelore është edhe e drejta e pronës. Do të doja të përmendja një vendim unifikues të Gjykatës së Lartë dhe një vendim të Gjykatës Kushtetuese që tregojnë rëndësinë e garancive procedurale që ofron neni 42 në respektimin dhe realizimin e së drejtës për pronë, sanksionuar nga neni 41.

Me gjithë ndryshimet ligjore çështja e pronës nuk ka gjetur ende një rregullim të plotë e përfundimtar. Duke njohur këtë problem, Kushtetuta i ka kushtuar një nen të veçantë, nenin 181 të saj. Kuvendi, në bazë të kësaj dispozite, detyrohet që brenda dy ose tre vjetëve nga hyrja në fuqi e Kushtetutës nxjerr ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj kushtetute duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41. Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para kësaj date dhe që kanë të bëjnë me shpronësimet dhe konfiskimet, do të zbatohen kur nuk vijnë në kundërshtim me të. Në bazë të kësaj dispozite Kuvendi ka ngritur një komision të posaçëm. Në gjirin e komisionit vërehet debat i gjallë dhe ende s' shihet një zgjidhje përfundimtare, megjithë mprehtësinë e problemit në realitetin shqiptar. Përpjekjet për të ndrequr gjendjen arritën një kulm me miratimin e Ligjit nr.7698 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve". Duke qenë se ky ligj përfaqëson një akt normativ bazë dhe shumë të rëndësishëm në rivendosjen e të drejtës së pronës private në Shqipëri, do të doja të ndalesha për të bërë një ekspozitë të ligjit dhe të problemeve që vërehen në të. Miratimi i këtij ligji shënoi një hap progresiv. Shteti merrte përsipër të rinjihte të drejtën e pronës private, e drejtë e mohuar për një periudhë të gjatë 50 – vjeçare. Në dispozitat e tij u parashikuan njohja dhe kthimi i të gjitha pasurive të paluajtshme që kanë qenë në pronësi private. Ky ligj sanksionoi të drejtën e pronësisë për ish pronarët dhe trashëgimtarët e tyre mbi pasurinë e paluajtshme të shtetëzuar, konfiskuar, marrë pa të drejtë nga shteti në çdo mënyrë tjetër. Ky ligj parashikon rastet kur kthimi është objektivisht i pamundur ose ndalohet me ligj për hir të nevojave publike. Shpeshherë është bërë pyetja nëse përfaqëson ky ligj një mënyrë të fitimit të pronësisë? Nga tërësia e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë që shqyrtojnë momente të këtij ligji mbizotëron mendimi se ky ligj nuk është mënyrë e fitimit të pronësisë. Ai vetëm rivendos një të drejtë të mëparshme të ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre.

Ajo që përbën rëndësi thelbësore me miratimin e

Ligji nr.9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" me ndryshimet përkatëse. Ky ligj krijon mundësinë e një amnistie juridike për të gjitha ato ndërtime dhe shtesa pa leje që nuk kanë respektuar rregullat e ligjit "Për Urbanistikën" duke i dhënë mundësinë të gjithë atyre subjekteve që kanë kryer një ndërtim të tillë para hyrjes në fuqi të këtij ligji ta legalizojnë atë. Ky ligj ka qenë objekt i veprimtarisë edhe të Gjykatës Kushtetuese e cila në vitin 2007 vendosi të rrezojë kërkesën e shoqatës "Pronësi dhe Drejtësi" për shfuqizimin e ligjit "Për legalizimet e ndërtimeve pa leje".

Maho Besnik "Fitimi i pronësisë mbi sende të paluajtshme" faqe 134-135, shtëpia botuese UET Press, Tiranë 2009.

Vendimi unifikues nr.24, datë 13.03.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, del në konkluzionin se subjektet e shpronësuara

ligjit nr. 7698, dt. 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve" është fakti se ky ligj ka qenë objekt i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës të Lartë në lidhje me raportin e përparësisë që ka në lidhje me ligje të tjera. Në një prej vendimeve të tyre unifikuese, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës të Lartë, arsyetojnë, "Për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore konkludojmë se, sa herë që përplasen interesat e ish pronarëve që përfitojnë nga dispozitat e Ligjit Nr.7698 me interesat e sindikatave të rregulluara nga Ligji Nr.8340, përparësi ka mbrojtja e interesave të ish pronarëve. Ligji nr.8340 është i zbatueshëm për atë që nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 7698. Edhe sikur dekreti nr.204 të kish marrë fuqi juridike rregullisht, duke u kundër firmuar nga Kryeministri ose Ministri i Financave, si dhe të ish miratuar nga Kuvendi në sesionin më të afërt, përparësi do të kish ligji për kthim dhe kompensim të pronave ish pronarëve kundrejt dekretit mbi pasurinë e sindikatave. Me hyrjen në fuqi, Ligji nr.7698 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve solli një rregullim të plotë e të drejtë të problemit të kthimit apo të kompensimit të ish pronarëve. Ligjvënësi vendosi të kthejë në natyrë dhe jo të kompensojë të gjitha ndërtesat e pandryshuara e trojet e lira të ish pronarëve, pa bërë përjashtim nëse këto vazhdonin të ishin në pronësi të shtetit, apo kishin kaluar në pronësi të pronarëve të tjerë. Ky rregullim zbatohet pa përjashtim dhe kundrejt atyre që i kishin përfitur këto prona kundrejt shpërbërimit e me mirëbesim dhe i kishin poseduar e gëzuar ato paqësisht për një kohë të gjatë. Gjithashtu nënvizojmë se Ligji nr. 7698 në nenin 29 të tij parashikon se: **"Të gjitha dispozitat ligjore që vijnë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen."** Në këtë drejtim nuk do të bënte përjashtim dhe dekreti nr. 204 sikur ai të kish marrë fuqi juridike rregullisht. Ai do të gjente zbatim vetëm brenda hapësirës që nuk do të krijonte ndeshje me ligjin e kthimit dhe kompensimit të pronave. Brenda kësaj hapësire do të gjejë zbatim gjithashtu edhe Ligji nr.8340, i cili ka marrë përsipër të rregullojë pasojat që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit. Në të gjitha rastet kur ka konflikte midis ish pronarëve e sindikatave, përparësi në zgjidhjen e tyre merr interpretimi e zbatimi i Ligjit nr. 7698". Ligji nr.7698 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve" do t'i shtrinte efektet e tij deri në vitin 2004, kohë në të cilën Kuvendi i Shqipërisë do të miratonte ligjin nr. 9235 datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" i ndryshuar i cili është aktualisht në fuqi. Ligji nr.9235 datë 29.07.2004 "Për kthim dhe kompensimin e pronës" i ndryshuar, është një ligj i cili në raport me ligjin nr. 7698, dt. 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve", ka rritur ndjeshëm mundësitë për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave subjekteve të shpronësuara, ku do të veçonim:

mundësinë e subjekteve të shpronësuara për t'ju njohur dhe kthyer toka bujqësore deri në 100 ha.

mundësinë e subjekteve të shpronësuara për t'ju njohur dhe kthyer pa kufizim trojet, pyjet dhe kullotat që mund të kenë patur ata apo trashëgimlënësit e tyre para reformës agrare.

mundësinë e subjekteve të shpronësuara për t'ju njohur dhe kthyer toka bujqësore, pyje, kullota apo livadhe në zona turistike me përjashtim të atyre zonave turistike që mbartin një interes publik të dukshëm.

mundësinë e subjekteve të shpronësuara që ende nuk kanë përfitur një kompensim real, për t'ju drejtuar me kërkesë të re Z.R.K.K.P në nivel qarku, me qëllim kthimin e pronës që duhet t'u kompensohet sipas vendimeve të mëparshme të K.V.K.K. Pronave, në rast se ndodhen para një situatë të re juridike dhe faktike.

mundësinë e subjekteve të shpronësuara që së bashku me të drejtën e parablerjes mbi një objekt shtetëror që ka humbur interesin publik, të regjistrojnë në ZRPP edhe sipërfaqen e truallit mbi të cilin ngrihet objekti shtetëror në emrin e tyre.

asnjë truall, tokë bujqësore nuk mund t'u kthehet ish pronarëve dhe t'u njihet e drejta e parablerjes mbi objektet pronë shtetërore, pa marrë më parë pëlqimin nga institucioni shtetëror që administron objektin përkatës, nëse objekti shtetëror mbart apo jo interes publik.

toka bujqësore u kthehet dhe u kompensohet subjekteve të shpronësuara, pasi të jetë zbritur toka bujqësore që ata kanë përfitur nga ligji nr.7501 dt.19.07.1991 "Për Tokën", mbi bazën e një hetimi të plotë administrativ.

Për sa i përket ligjit nr. 9235 datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" i ndryshuar mund të themi se ai i ka rritur ndjeshëm standardet për njohjen e së drejtës të pronësisë në aspektin formalo-juridik. Ajo që ngelet një problem në lidhje me qëllimin që përcjell ky ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, nuk ka të bëjë me tepër me përmbajtjen sesa me mungesën e vullnetit të duhur për trajtimin brenda afateve ligjore të kërkesave të subjekteve të shpronësuara si dhe të kompensimit real të pronave të paluajtshme të këtyre subjekteve për të cilët është bërë shumë pak. Kjo është edhe një nga arsytet që, vendimet të cilat kanë penalizuar vendin tonë nga ana e GJEDNj për shkelje të nenit 1 të Protokollit 1, kanë të bëjnë me këtë proces problematik dhe mjaft të ndërlikuar në lidhje me të drejtën e pronësisë të subjekteve të shpronësuara, për të gjitha ato prona të mara padrejtësisht nga regjimi monist pas vitit 1944 dhe për mos zgjidhjen efektive të problematikës të krijuara në shumicën e kërkesave të paraqitura ende dhe sot. Çështjet e pronësisë që lidhen me kthimin apo kompensimin e ish pronarëve të shpronësuara gjatë regjimit komunist vazhdojnë të mbeten një nga problemet kryesore. Janë bërë amendime të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave, duke përcaktuar kritere të reja për vlerësimin e tokës, dhe duke zgatur afatin e vazhdimin të procesit të kthim-kompensimit. Ndryshimet e herë pas hershme të kuadrit ligjor për të drejtën e pronësisë, pavarësisht se kanë ardhur si pasojë e nevojave për përmirësimin e tij, shpesh kanë sjellë mbivendosjen e kompetencave të institucioneve përgjegjëse në këtë fushë. Në 2012 është miratuar një strategji gjithëpërfshirëse, e cila synon të përfundojë procesin e kthimit e kompensimit të pronave, duke krijuar një skemë eficiente për kompensimin fizik, si edhe një fond financiar më të lartë për kompensimin financiar. Regjistri elektronik i tokës nuk ka përfunduar ende dhe baza e të dhënave për pronat ka

kanë humbur vetëm të drejtën e posedimit dhe gëzimit mbi pronat e paluajtshme që u janë shpronësuara dhe jo tagrin e disponimit si dhe vetë pronësinë mbi to.

Vendimi unifikues nr.85, datë 29.06.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Maho Besnik "Fitimi i pronësisë mbi sende të paluajtshme" faqe 171-172, shtëpia botuese UET Press, Tiranë 2009.

mbetur ende nën kontrollin e agjencive të ndryshme ligj zbatuese. Përpyqje serioze duhen bërë në garantimin e ekzekutimit të vendimeve të gjykatave të vendit, si edhe atyre të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut, që lidhen me të drejtën e pronësisë.

Moskthimi i pronave të shpronësuara apo të shtetëzuara në mënyrë të padrejtë subjekteve të shpronësuara apo pamundësia e një kompensimi efektiv të tyre ka qenë objekt i veprimtarisë të GJEDNJ në çështjen Çështja Driza vs. Shqipërisë (13.11.2007)

OBJEKTI : Cenim i së drejtës për siguri juridike, pasi një vendim i 1998 që i njihte aplikantit të drejtën për kompensim për pronat e shtetëzuara gjatë regjimit komunist, është prishur dy herë nga Gjykata e Lartë. Konstatim i mungesës së paanshmërisë së Gjykatës së Lartë, pasi kryetari i saj dhe një pjesë e gjyqtarëve të trupës gjyqësore ishin shprehur edhe më parë për çështjen në fjalë, në shkallët e tjera të gjykimit. Mangësi në ekzekutimin e vendimit përfundimtar, që cenon të drejtën për akses në gjykatë në mënyrë efektive, si edhe të drejtën për një zgjidhje efektive.

VENDIMI: Gjykata ka urdhëruar kthimin fizik të pronës për aplikantin, si edhe detyrimin e Shtetit për të paguar një dëmshpërblim.

Çështja Gjonboçari dhe të tjerë vs. Shqipërisë (23.10.2007)

OBJEKTI : Mos ekzekutimi i një Vendimi të Gjykatës së Lartë i vitit 2003, që urdhëronte Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të shprehur me një vendim në lidhje me pretendimet e aplikantit mbi pronat e konfiskuara nga shteti. Tejzgjatje e procedurave të mbartura që nga viti 2000, si edhe mungesa e një zgjidhjeje efektive.

VENDIMI : Gjykata ka urdhëruar pagesën e një dëmshpërblimi, si edhe detyrimin e Shtetit për ekzekutimin e vendimit në mënyrën më të përshtatshme dhe në kohën më të shkurtër të mundshme.

Reformimi i legjislatcionit për zgjidhjen e çështjeve të pronësisë

Nga një analizë e historisë legjislative mbi të drejtat e pronësisë konstatohet se problematika është komplekse. Ekzistojnë të paktën 16 ligje të veçanta që rregullojnë sektorë të ndryshëm të të drejtave të pronësisë, që krijojnë organe shtetërore për mbikëqyrjen sektoriale dhe që përcaktojnë procedura të veçanta. Këto ligje janë ndryshuar dhe rishikuar vazhdimisht, duke synuar të zgjidhin të drejta të caktuara të pronësisë në favor të subjekteve të caktuara.

Të gjitha këto ligje si dhe ndryshimet e shpejta që atyre ju janë bërë, kanë pasur si qëllim përmirësimin e cilësisë të shërbimit dhe atë të garantimit të titullit të pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme në favor të subjekteve që kanë përfutur nga secili ligj.

Gjithsesi, i gjithë ky kuadër ligjor së bashku me ndryshimet përkatëse që ka pësuar secili ligj, ka shkaktuar jo pak konfliktualitet sociale dhe juridike nga mbivendosje apo kolizioni i ligjeve.

Gjithashtu institucionet përgjegjëse ligj zbatuese për secilin ligj, funksionojnë në mënyrë të fragmentarizuar (aktualisht Shqipëria, ka mbi 8 institucione ose Agjenci që veprojnë mbi të drejtat e pronësisë, në varësi të ministrive të ndryshme përgjegjëse, veprimtaria e të cilave rregullohet nga pjesë të ndryshme legjislatcionit. Ato trajtojnë në mënyrë të fragmentarizuar çështje të fitimit të pronësisë dhe të regjistrimit të titujve të pronësisë). Numri i lartë i agjencive shtetërore dhe legjislatcionit rregullator i shumtë krijojnë mbivendosje të proceseve që lidhen me të drejtat e pronësisë. Këto faktorë ndikojnë edhe në zbatimin e vendimeve përfundimtare, si dhe krijojnë paqartësi për mjetet efektive të ankimit në rastet e moszbatimit të vendimeve përfundimtare. Infrastruktura teknike dhe burimet njerëzore kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme të stafit. Agjencitë shtetërore dhe gjykatat, në çështjet që prekin të drejtat e pronësisë perceptohen se janë të prekura nga korrupsioni.

Transparency International, përmes nismës CIMAP, në vitin 2011 ka vënë në dukje se ka problem institucionale që komprometojnë zbatimin e ligjeve, të cilat prekin aftësinë e gjyqësorit, ligjvënësit dhe të administratës publike për të funksionuar me efektivitet dhe efikasitet. Publiku nuk ka besimin e duhur tek shërbimet e ofruara nga agjencitë, shërbimet nuk janë të shpejta dhe transparente sa duhet. Për të parandaluar këtë fenomen dhe për rikthimin e besimit të qytetarëve tek institucionet ka filluar edhe procesi i dixhitalizimit tërësor, përfundimi i të cilit do të japë rezultatet e duhura.

Aktualisht për adresimin e kësaj problematike, me Urdhrin e Kryeministrit nr. 110, datë 31.12.2011 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, bazuar në VKM-në nr. 350, datë 29.4.2011 “Për miratimin e plan-veprimit për zgjidhjen e problematikës së çështjeve të pronësisë, e identifikuar në Memorandumin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës”, në Ministrinë e Drejtësisë është ngritur Drejtoria e Koordinimit të Çështjeve të Pronësisë. Struktura dhe organika e saj është pjesë e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Drejtësisë. Ajo koordinon veprimtaritë e institucioneve shtetërore të përfshira me çështjet e pronësisë si AKKP-së, ZRPP-së, ALUIZNI-it, DASHPP-së, KQT-së, AITTP, EKB⁷

. Reforma legjislative që ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtës të pronësisë, si një prej të drejtave themelore të individit në një demokraci ku sundon ligji, aktualisht, përbën një nga 12 pikat kryesore që duhet të realizohen që Shqipëria të marrë Statusin

Strategjia për të Drejtat e Pronësisë si pjesë e Strategjisë Afatgjatë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, (miratuar për periudhën 2013-2020, në mbledhjen e Komitetit të Planifikimit Strategjik, 20 Dhjetor 2011), fq. 4-5

Agjencia e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronës për subjektet e shpronësuara, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për regjistrimin e pronave, Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor për ekzekutimin e vendimeve, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave Informale për legalizimin e ndërtimeve informale, Avokatura e Shtetit për mbrojtjen e interesave pasurore të shtetit dhe përfaqësimin në GJEDNJ, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pasurive të Paluajtshme për pasuritë shtetërore, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjeve të Pasurive të Paluajtshme për pasuritë shtetërore, Komisioni Qeveritar i Tokës për vlefshmërinë e titujve të pronësisë dhe Enti Kombëtar i Banesave për banesat sociale.

e vendit kandidat në BE. Reformimi i të drejtave të pronësisë i shërben konsolidimit të investimeve të shtetasve shqiptarë, si edhe investimeve të huaja, sepse e shndërron Shqipërinë në një vend të sigurt dhe tërheqës për to. Përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues dhe zbatimi i tij, nëpërmjet edhe përfshirjes së grupeve të interesit, e shndërron tregun e pronës në një faktor të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik. Megjithatë miratimi i ligjeve është një hap tepër i rëndësishëm në rrugën drejt suksesit, ka ende shumë për të bërë në eliminimin e pasigurive ligjore në fushën e çështjeve të pronësisë (për shkak të ndeshjes apo kolizionit të ligjeve).

Për të zgjidhur drejt këtë çështje në vitin 2011 është miratuar Strategjia afatgjatë e zgjidhjes të këtij problem që I përket viteve 2011-2020. Kjo strategji, duke marrë parasysh problemet komplekse që mbartin të drejtat e pronësisë, për zgjidhjen e këtyre problemeve, bazohet në vullnetin politik të orientuar drejt një qasjeje gjithëpërfshirëse, në mënyrë që të përmbushen standardet ndërkombëtare ekzistuese, si dhe të baraspeshohen interesat dhe nevojat e grupeve të ndryshme të interesit në shoqëri. Kjo strategji kombëtare pritet të adresojë problemet e shumëfishta dhe të identifikojë mënyrat për të balancuar titujt kontradiktorë mbi pronën në një mënyrë të drejtë.

Parimet që udhëheqin strategjinë janë të dimensionit kushtetues dhe lidhen me interesin publik, shpërblimin e drejtë, parimin e drejtësisë, të proporcionalitetit dhe të shtetit social, duke u bazuar jo vetëm në elaborimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por edhe nga jurisprudenca, tashmë e pasur, e Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu, strategjia merr në konsideratë edhe parimet e sigurisë juridike dhe të qartësisë të legjislacionit, si premisa thelbësore të forcimit të të drejtave themelore, paralelisht me zhvillimin e vendit dhe tërheqjen e investimeve të huaja. Përparësitë e Strategjisë për të Drejtat e Pronësisë janë: futja në rrugën e duhur të zgjidhjes përfundimtare të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave, integrimin e zonave dhe ndërtimeve informale të legalizuara, përfundimi i regjistrimit fillestar të gjitha pasurive, dixhitalizimi i sistemeve.

Strategjia mban në konsideratë edhe faktin që për sektorë të caktuar veprojnë strategji të veçanta qeveritare, si Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Luftën kundër Korrupsionit dhe për një Qeverisje Transparente dhe Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë, Strategjia e privatizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, strategjia për barazinë gjinore, projekt strategjia për konsolidimin e tokës. Strategjia shfrytëzon gjetjet dhe rekomandimet e Memorandumit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, nga analiza e të cilit del e nevojshme një zgjidhje gjithëpërfshirëse e problemit të të drejtave të pronësisë, bazuar jo vetëm në sfidat aktuale që Shqipëria po kalon, por edhe në eksperiencat e ngjashme të vendeve të tjera anëtare të Këshillit të Evropës në zbatim të vendimeve të GjEDNJ-së. Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 350, datë 29.04.2011 ka miratuar një plan të posaçëm veprimi për zgjidhjen e problematikës së identifikuar në Memorandumin e Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës – dokument, i cili është mbajtur gjithashtu në konsideratë.

Në përfundim të kësaj analize të situatës mbi të drejtën e pronës në Shqipëri rezultojnë këto problematika kryesore:

Agjencitë ligj zbatuese dhe gjykatat perceptohen si shumë të prekura nga korrupsioni dhe besimi i publikut në performancën e tyre ka rënë ndjeshëm.

Ndryshimet e shpeshta të kuadrit ligjor mbi pronësinë kanë shtuar më shumë konfuzionin, dukë cenuar parimin e sigurisë juridike

Vihet re mos-ekzekutimi i vendimeve administrative, gjyqësore dhe vendimeve të GJEDNJ, që lidhen me pronësinë.

Nuk ka të dhëna të sakta mbi faturën financiare që rëndon mbi shtetin për të përfunduar procesin e kompensimit të pronës.

Dokumentacioni mbi pronat është i shpërndarë në disa institucione dhe sigurimi i tyre është shumë i vështirë.

ZRPP nuk ka përfunduar ende regjistrimin fillestar duke rritur shkallën e konflikteve nga mbivendosjet.

Agjencitë shtetërore karakterizohen nga tejzgjatje të procedurave vendimmarrëse

Mungon bashkëpunimi institucional ndërmjet institucioneve dhe ka mbivendosje të përgjegjësive dhe kompetencave.

Rastet e ndëshkueshmërisë për nënpunësit që shkelin ligjin janë pothuajse inekzistente

Problemet e pazgjidhura me pronën sjellin pengesa në zhvillimin ekonomik dhe veçanërisht në tërheqjen e investitorëve të huaj (kryesisht për të investuar në fushën e turizmit)

Mungesa e transparencës në trajtimin e çështjes së kompensimit të pronave ka kompromentuar të gjithë procesin.

Përfundime

Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe pastrimi i legjislacionit nga mbivendosja e kompetencave si edhe plotësimi i tij me akte nënligjore Zbatimi me korrektësi i ligjit, rritja e efencës dhe shkallës së transparencës në administratë. Të rritet shkalla e koordinimit midis institucioneve që trajtojnë çështjet e pronësisë Përfundimi i procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave, procesit të legalizimit dhe atij të vlerësimit të titujve të pronësisë brenda afateve ligjore Përfundimi i regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme dhe dixhitalizimi i të dhënave.

Rritja e efencës së sistemit të përmbartimit privat për ekzekutimin e vendimeve që lidhen me pronësinë Nxjerrja e të dhënave të sakta mbi numrin e kërkesave për kthim, kompensim, si edhe e vendimeve gjyqësore mbi çështjet e pronësisë, në

Strategjia për të Drejtat e Pronësisë si pjesë e Strategjisë Afatgjatë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, (miratuar për periudhën 2013-2020, në mbledhjen e Komitetit të Planifikimit Strategjik, 20 Dhjetor 2011), fq 3

Po aty fq 2

mënyrë që të përllogariten kostot e nevojshme për përfundimin e këtyre proceseve. Reduktimi në maksimum i kontakteve të qytetarëve me institucionet që disponojnë ose prodhojnë dokumente pronësie deri në regjistrimin e saj, mundësisht sipas modelit “one stop shop”. Ulja e masës së tarifës gjyqësore për paditë e rrjedhura nga marrëdhëniet kontraktore, si dhe ato për shkaktim dëmi me vleftë mbi 100 000 lekë, e cila aktualisht është 3% e vlerës së padisë, duke sjellë aksesin e pabarabartë të qytetarëve në gjykatë

Nga sa më sipër, përfundimi i proceseve që lidhen me kthimin e kompensimin e pronës, legalizimin e ndërtimeve informale, regjistrimin fillestar të titujve të pronësisë, si edhe me vlefshmërinë juridike të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, duhet të shihen me prioritet dhe seriozitet nga të gjithë aktorët në këtë fushë. Autoritetet shtetërore duhet të udhëhiqen nga parimi i transparencës dhe i korrektesës për zgjidhjen e këtij problemi thelbësor, që prej vitesh u ka mohuar qytetarëve të drejtën për të gëzuar një ndër të drejtat themelore të tyre, të drejtën e pronës. Është e nevojshme vendosja e urave të bashkëpunimit midis organizatave të shoqërisë civile këto shoqata, në mënyrë që përpjekjet e secilit prej aktorëve në këtë drejtim të bashkohen, për t’u përkthyer në ndryshime ligjore apo administrative.

EFEKTIVITETI I RELAKSIMIT PROGRESIV NË REDUKTIMIN E ANKTHIT NË NJË KAMPION JO-KLINIK

FLEURA SHKËMBI

ERIKA MELONASHI

NAIM FANAJ

ABSTRAKT

Çrregullimet e ankthit janë të pranishme pothuajse në të gjitha kulturat dhe ato e reduktojnë cilësinë e jetës, ku me prevalencë mjaft të shprehur është ankthi i përgjithësuar. Ankthi ndërmjet studentëve të universitetit është krejt i zakonshëm. Qëllimi i studimit ishte njohja me efektet e përdorimit të tekniks së relaksimit progresiv në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës. Për nga dizejimi përdorëm një studim gjysmë eksperimental, në të cilin u aplikua Relaksimi Progresiv, me qëllim reduktimin e ankthit të përgjithësuar në rastet e studentëve të grupmoshës 20-30 vjeç. Kampioni përbëhej nga 214 studentë të përzgjedhur rastësisht. Si instrument vlerësues u përdor Pyetësi i ankthit të përgjithësuar GAD-7 (alfa= .843). Në fazën e dytë të studimit u përzgjedhën 10 femra dhe 10 meshkuj nga kampioni i mësipërm. Këta u ndanë në dy grupe (Relaksimi Progresiv dhe grupi kontrollit). Në fazën e tretë, pasi u ritestuan me GAD-7, pjesëmarrësve ju dërgua një intervistë e shkurtër në lidhje me trajtimin dhe efikasitetin e teknikës. Nga rezultatet sasiore del se teknika e relaksimit është më efektive se pritja si grup kontrolli në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës. Duhet të merren në konsideratë aplikime të relaksimit progresiv në rastet me ankth në popullatën joklinike.

Fjalë kyç: ankthi, studentët, relaksimi progresiv i muskujve, cilësia e jetës, GAD

Hyrje

Relaksimi progresiv i muskujve

Relaksimi progresiv i muskujve është një metodë, e cila u implementua nga Jacobson më 1938 dhe më pas ka vazhduar në variante nga më të ndryshmet, derisa sot mund të themi, që kjo teknikë e teorisë së sjelljes është përshtatur në shumë fusha të tjera të terapisë, mjekësisë, në sport, në edukim; sepse relaksimi redukton stresin, ankthin, ul nivelin e frikërave dhe fuqizon pacientët në nivel fizik, psikologjik dhe emocional. Kjo teknikë konsiston në realizimin e tendosjes të një grupi të caktuar muskujsh dhe më pas në shtendosjen e tyre, me qëllim që të arrihet relaksimi. Kjo teknikë, mund të përdoret si pjesë e terapisë ose si detyrë shtëpie, ku pacienti mund të arrijë ta përjetojë këtë relaksim, pasi është trajnuar nga terapisti.

Në ditët e sotme relaksimi progresiv përdoret në fushën klinike për të ulur tensionin mendor. Në bazë të të dhënave, mendja qetësohet kur relaksohen muskujt. Jacobson (1938), është i pari në zhvillimin fillestar të procedurës së relaksimit progresiv të muskujve. Prej asaj kohe është përmirësuar dhe modifikuar, dhe procedurat relaksuese janë përdorur shpesh në kombinim me një numër teknikash mbi sjelljen. Përdorimi më i zakonshëm ka qënë me problemin lidhur me stresin dhe ankthin, të cilët manifestohen shpesh me simptoma psikosomatike. Freeman (2001) argumenton se teknikat PMR zbehin eksitimin simpatik duke trajnuar individin për të reduktuar nevojat për oksigjen, të arritura nga çlirimi i përsëritur i tensionit muskular, i kombinuar me ngadalësimin e frymëmarrjeve. Kjo e bën atë një ndërhyrje terapeutike funksionale për panikun, fobitë dhe gjendjet e ankthit.

Ankthi

Ankthi, është një ndër emocionet që përjetohe me gjerësisht, i përkufizuar si ndjenjë e papëlqyeshme paretie, nervozizmi, ankthi, frike, shqetësimi ose merak (Barlow, 2002; Karatas, Alci & Aydin, 2013; Lenka & Kant, 2012). Në të vërtetë, ankthi i moderuar mund t'i motivojë njerëzit për të menaxhuar problemet e tyre dhe të kenë një sukses në jetën e tyre (Abolghasemi, Mehrabizadeh-Honarmand, Najarian, & Shokrkon, 2004). Megjithatë, ankthi mundet gjithashtu të përshkallëzohet me çrregullime. Në të vërtetë çrregullimet e ankthit, janë lloji më i përhapur i çrregullimeve psikologjike. Çrregullimet e ankthit janë të pranishme pothuajse në të gjitha kulturat (Demyttenaere, 2004). Të dhënat tregojnë, që përjetohe nga afërsisht 18% e të rriturve çdo vit dhe nga afërsisht 32% e njerzve gjatë gjithë jetës së tyre (Kessler 2005). Ankthi e redukton cilësinë e jetës (Cramer, 2005; Rapaport et al, 2005; Saarni, 2007) dhe kontribuon në paaftësi (Bloom etj, 2011), duke shkaktuar dëmtim të rëndë profesional dhe humbje të produktivitetit (Greenberg etj. 1999, Ormel, 1994). Pavarësisht nga rëndësia dhe përhapja, pak njerëz me çrregullime të ankthit marrin trajtim profesional (Wittchen, 2002).

Çrregullimi i ankthit të përgjithësuar

Tipari themelor i çrregullimit ishte “ankthi i vazhdueshëm” për të paktën një muaj, duke përfshirë tensionin motorik, hiperaktivitetin autonom, pritshmërinë frikësuese, dhe vigjilencën/kontrollin. Duket se njerëzit me GAD vazhdimisht shqetësohen më shumë për çështje të vogla, krahasuar me individët joklinikë dhe njerëzit me çrregullime të tjera të ankthit (Brown, Moras, Zinbarg, & Barlow, 1993; Hoyer, Becker, & Roth, 2001). Studimet epidemiologjike kanë gjetur prevalencën tërë jetësore prej 2,5-8 %. GAD-i, si një çrregullim i pavarur, është një problem i rëndësishëm për shëndetin publik.

Ankthi dhe cilësia e jetës

Cilësia e jetës përfshin perceptimet e individit në lidhje me pozicionimin e tyre në jetë, në kontekst të sistemit të vlerave dhe në raport me qëllimet, pritshmëritë, standardet në kontekstin përkatës social-kulturor (Szabo, 1996). Koncepti i cilësisë së jetës, është një pikë shumë e rëndësishme në studimet mbi shëndetin mendor dhe ka pasur një rritje të numrit të studimeve shkencore mbi këtë tematikë (Schneider, Maclennan, & Freeny, 2008). Në vitin 2000 Mendlowicz and Stein në analizën e tyre sistematike të studimeve kanë gjetur, se çrregullimet e ankthit, ulin konsiderueshëm cilësinë e jetës dhe funksionimin psikosocial (Mendlowicz & Stein, 2000). Në përgjithësi, studimet epidemiologjike dhe klinike kanë gjetur, se individët me GAD përjetojnë dëmtim sinjifikativ në cilësinë e jetës edhe pas kontrollimit të efekteve të mundshme të komorbiditetit mjekësor dhe psikiatrik (Ritsner, & Awad, 2007).

Ankthi në mjediset studentore. Vlerësimet tregojnë se rreth 75% e të gjithë individëve me çrregullime të ankthit do ta përjetojnë atë gjatë studimeve të tyre. (Bolden, 2008; Margarita, 2008). Yılmaz dhe Ocaççı (2010) zbuluan se 77.2% e studentëve përjetuan një nivel të qetë të ankthit dhe 19.6% një nivel mesatar. Niveli i ankthit mund të ndërhyjë dhe vështirësojë në funksionimin e përditshëm si studimet, aktivitetet e përditshme, si dhe jetën shoqërore ndërmjet studentëve (McCraty, 2007; McCraty, Dana, Mike, Pam & Stephen, 2000)

Trajtimi i ankthit me anë të relaksimit progresiv të muskujve

Teknikat e relaksimit janë konsideruar, si një terapi ndihmëse për trajtimin e stresit, ankthit dhe depresionit dhe mund t'ju sigurojnë pacientëve aftësi përballuese mbi vetë-mirëmbajtjen për të reduktuar këto simptoma (Chida, Steptoe, Hirakawa,

Sudo, & Kubo, 2007). Në rishqyrtimin e teknikave të relaksit (Kerr, 2000) citohen studimet, të cilat tregojnë reduktimin e nivelit të stresit tek indikatorët fiziologjikë dhe psikologjikë, pas përdorimit të një kursi të relaksimit progresiv. Ndërmjet disa teknikave të relaksimit, relaksimi progresiv i muskujve (PMR) është zbuluar të jetë efektive në çrregullime me një komponent të fortë psikologjik. (Vickers & Zollman, 1999). Paul (1969) arriti të provonte, se një seancë e vetme rezultoi në ulje të konsiderueshme në masat fiziologjike të tilla si, norma e zemrës, tensioni i muskujve dhe norma e frymëmarrjes në krahasim me procedurat e kontrollit. Nickel et al., (2005) ka ofruar gjithashtu mbështetje për aplikim të vetëm të seancës PMR. Në vitin 2005, Pavlov dhe Jones (2005) vërtetuan se, një seancë e vetme prej 20 minutash e PMR prodhoi ndryshime të rëndësishme në funksionin e sistemit imunitar. Studimi i kryer nga Rausch et al., (2006) sugjeroi, që zbatimi PMR në individë që vuajnë nga nivele të larta të ankthit klinikisht mund të jetë i dobishëm. Wolf dhe Abell (2003) mbështetën këtë konstatim, duke treguar se PMR ishte efektive në uljen e nivelit të ankthit në nivele normale. Conrad & Roth (2007) ka deklaruar se PMR ka vazhduar të luajë një rol të rëndësishëm në trajtimin modern të çrregullimeve të ankthit. Schreiber & Schreiber (1995) në një studim treguan suksesin e relaksimit për të përmirësuar arritjet akademike të studentëve. Një shqyrtim (Manzoni, Pagnini, Castelnovo, Molinari, 2008) thekson heterogjenitet të konsiderueshëm në një meta-analizë të studimeve të përfshira. Një tjetër studim nga Dress, Ayres & Beechley (2009) ka zbuluar se mësimi i teknikave të relaksimit përmirëson funksionalitetin njohës, ekuilibrin emocional dhe të sjelljes dhe cilësinë e jetës.

Metodologjia

Qëllimi i këtij studimi ishte njohja me efektet e përdorimit të teknikës së relaksimit progresiv të muskujve në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës. Ky ishte një studim *gjysmë eksperimental* në të cilin u aplikua metoda e relaksimit progresiv të muskujve.

Dizenjimi i studimit & procedura

Gjatë fazës së parë të studimit, kampioni që plotësoi testin ishin 240 studentë të përzgjedhur në mënyrë krejt rastësore në shkollat private dhe publike. 26 pyetësorë dolën të pavlefshëm. Bazuar në rezultatet që dolën nga pyetësori i GAD, prej 214 studentëve që kanë plotësuar pyetësorët, grupet u krijaun në bazë të nivelit të ankthit nga 5 deri në 14 (5-9 nivel i ulët dhe 10-14 nivel i moderuar). Përsa i përket nivelit të ankthit, ANOVA testi tregoi se nuk kishte diferenca sinjifikative mes grupeve. Grupi i relaksimit progresiv (N=10, M=8.4, SHS=2.5) dhe grupi i kontrollit (N=10, M=10.5, SHS=3.2). Përsa i përket moshës Grupi i relaksimit progresiv ishte nga 20-29 vjeç (N=10, M=22.6, SHS=2.67) dhe grupi i kontrollit ishte nga 19-23 vjeç (N=10, M=21.5, SHS=1.43). Te grupi i *Relaksimit Progresiv të Muskujve* u përdor i njëjti protokoll në të gjitha seancat, induksioni i Relaksimit Progresiv të Hartland. Te grupi i pritjes nuk u ndërmor asnjë aktivitet. Në fazën e katërt, pasi përfundoi trajtimi, u riadministrua sërish testi GAD-7. **Instrumentet e studimit:** Për mbledhjen e të dhënave në studim është përdorur: *Pyetësori i ankthit të përgjithësuar (GAD-7)* (Spitzer, Kroenke, Williams & Löwe, 2006) i plotësuar me disa pyetje lidhur me vështirësitë në shtëpi, punë dhe marrëdhënie me të tjerët. Konsistenca e brendshme në studim ishte e lartë: $\alpha = .843$

Rezultatet

Analiza sasiore për trajtimin e çrregullimit të ankthit të përgjithësuar

Grupi i Relaksimit Progresiv të Muskujve ka rezultuar një zvogëlim sinjifikativ në vlerat e ankthit prej vlerave para-trajtimit; ku GAD T1 (M=8.40; DS=2.50) dhe pas-trajtimit GAD T2 (M=5; DS=1.33), $t(10) = 5.20$, $p < .001$ (dy drejtimëshe). Zvoglimi i vlerës mestare ishte 3.40 me një interval konfidence prej 95 % që rangohet nga 1.92 deri në 4.87. Eta katrore (.75) teknika na tregon se ka një efekt të madh raporti (Tabela 1). **Grupi i Kontrollit** ka rezultuar një zvogëlim sinjifikativ në vlerat e ankthit prej vlerave para-trajtimit; ku GAD T1 (M=10.50; DS=3.20) dhe pas-trajtimit GAD T2 (M=8.80; DS=2.14), $t(10) = 3.43$, $p < .008$ (dy drejtimëshe). Zvoglimi i vlerës mestare ishte 1.70 me një interval konfidence prej 95 % që rangohet nga 5.79 deri në 2.82. Eta katrore (.56) teknika na tregon se ka një efekt të madh raporti (Tabela 1).

TAB. 1. STATISTIKA E ÇIFTEVE TË KAMPIONIT PËR LLOJET E TRAJTIMIT

Lloji i terapisë		Vlera mesatare	N	Shmangia standarde	Gabimi standard/Vlera mesatare
Relaksimi Progresiv	GAD TOTAL para trajtimit	8.4000	10	2.50333	.79162
	GAD TOTAL pas trajtimit	5.0000	10	1.33333	.42164

Kontrolli	GAD TOTAL para trajtimit	10.5000	10	3.20590	1.01379
	GAD TOTAL pas trajtimit	8.8000	10	2.14994	.67987

Me qëllim të **zëbrthimit më të detajuar të rezultateve** kemi përdorur ANOVA testin për të parë *dallimet e mundshme në mes të grupeve të krijuara në nivelin e GAD*. Rezultatet sasiore nxjerrin përfundimin se relaksimi progresiv është më efikas se jo trajtimi në grupin e kontrollit në reduktimin e ankthit të përgjithësuardhe në përmirësimin e cilësisë së jetës.

Krahasimet post-hoc me teknikën Games-Howell indikojnë se vlera mesatare për **Grupi i Relaksimit Progresiv** (M=5; DS=1.33) ka dallim sinjifikativ me **Grupi i Kontrollit** (M=8.80; DS=2.14) (Tabela 2).

TAB. 2. KRAHASIMET POST-HOC ME TEKNIKËN GAMES-HOWELL TE GAD PAS TRAJTIMIT

	N	Vlera mesatare	Shmangia standarde	Gabimi standard	95% Intervali konfidencës		Minimum	Makimum
					përvlerën mesatare	Kufiri i ultë		
Relaksimi Progresiv	10	5.0000	1.33333	.42164	4.0462	5.9538	3.00	8.00
Kontrolli	10	8.8000	2.14994	.67987	7.2620	10.3380	6.00	12.00

Ndikimi i trajtimit në nivelin e cilësisë së jetës sipas T-test i kampionit të çiftëzuar

T-test i kampionit të çiftëzuar është përdorur për të vlerësuar ndikimin e llojeve të trajtimeve të përdorura në vlerat e cilësisë së disafunksioneve jetësore të individit: *punës, kujdesit për shtëpinë dhe marrëdhënieve me të tjerët* pas trajtimeve të aplikuara.

Grupi i Relaksimi Progresiv: Ka rezultuar një zvogëlim sinjifikativ në vlerat e *vështirësive në punë* prej vlerave para-trajtimit; ku para-trajtimi T1 (M=1.80; DS=.63) dhe pas-trajtimit T2 (M=1.20; DS=.42), $t(10) = 2.753$, $p < .022$ (dy drejtimëshe). Zvogëlimi i vlerës mesatare ishte .8 me një interval konfidence prej 95 % që rangohet nga .142 deri në 1.457. Eta katrore (.45) teknika na tregon se ka një efekt të madh raporti. Nuk ka rezultuar një zvogëlim sinjifikativ në vlerat e *në kujdesin ndaj shtëpisë* dhe në marrëdhënie me të tjerët prej vlerave para-trajtimit (Tabela 3).

Grupi i kontrollit: Nuk ka rezultuar një zvogëlim sinjifikativ në vlerat e vështirësive në punë, në kujdesin ndaj shtëpisë dhe në marrëdhënie me të tjerët prej vlerave para-trajtimit (Tabela 3).

TAB 3. STATISTIKA E ÇIFTEVE TË KAMPIONIT PËR NDIKIMIN E TIPEVE TË TERAPISË NË CILËSINË E JETËS

Lloji i terapisë	Vlera mesatare	N	Shmangia standarde	Gabimi standard	Vlera mesatare
Relaksimi Progresiv	Puna para trajtimit	1.8000	10	.63246	.20000
	Puna pas trajtimit	1.2000	10	.42164	.13333
	Shtëpia para trajtimit	1.7000	10	.94868	.30000
	Shtëpia pas trajtimit	1.3000	10	.48305	.15275
	Marrëdhëniet para trajtimit	1.8000	10	.91894	.29059
	Marrëdhëniet pas trajtimit	1.0000	10	.00000	.00000
Kontrolli	Puna para trajtimit	1.6000	10	.51640	.16330
	Puna pas trajtimit	1.8000	10	.42164	.13333
	Shtëpia para trajtimit	1.8000	10	.63246	.20000
	Shtëpia pas trajtimit	1.3000	10	.48305	.15275
	Marrëdhëniet para trajtimit	1.7000	10	.67495	.21344
	Marrëdhëniet pas trajtimit	1.5000	10	.52705	.16667

Diskutime

Rezultatet sasiore kanë vërtetuar se *relaksimit progresiv të muskujve* ka efekt pozitiv në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës. *Grupi i Kontrollit* kishte ulje të nivelit të ankthit edhe pse në nivele tepër të ulëta. Pjesëmarrësit e dinin që do të merrnin pjesë në një studim për uljen e nivelit të ankthit, kështu që efekti Placebo (Lambert Bergin, 1994) është më se i shpjegueshëm në këtë rast, por nga analizat e mëtejshme statistikore duket qartë që nuk ka pasur efekt në përmirësimin e sjelljeve në dimensionet e jetës: punë, shtëpi dhe marrëdhënie me të tjerët. Konformë gjetjeve të Nikel etj., (2005); Rausch etj., (2006); Wolf & Abell (2003); Schreiber & Schreiber (1995) dhe Conrad & Roth (2007) edhe në këtë studim relaksimi progresiv i muskujve është treguar efektiv në trajtimin e ankthit. Teknika e *Relaksimit Progresiv* ka vepruar pozitivisht vetëm në vështirësitë në punë dhe kjo është e kuptueshme që nëse je i relaksuar do ta pasqyrosh edhe në marrëdhëniet e punës por nuk ka patur rezultat në marrëdhëniet me të tjerët dhe kujdesin ndaj shtëpisë. E njëjta rrjedhë shpjegimi vlen edhe për efikasitetin e kësaj teknike, sepse marrëdhëniet në punë janë të lidhura edhe në marrëdhëniet me të tjerët. Nga studimet ka rezultuar se mësimi i teknikave të relaksimit ka çuar në përmirësimin e funksionalitetit njohës, ekuilibrin emocionalë dhe të sjelljes në cilësinë e jetës (Dress, Ayres & Beechley, 2009). Te *Grupi i Kontrollit* nuk kemi ndikim në asnjë nga këto dimensionet, gjë që pritej të ndodhte me qënë se nuk u ndërrom asnjë hap për të trajtuar ankthin.

Kufizime

Ky studim ka një sërë kufizimesh të cilat duhen diskutuar. Përdorimi i testit GAD-7 nuk mjafton për të bërë një vlerësim substancial të ankthit. Poashtu GAD-7 është një test i pa standardizuar në Shqipëri dhe si i tillë ka mangësi në përdorim dhe në administrim. Administrimi i GAD-7 dhe trajtimi i pjesëmarrësve, i bërë nga i njëjti studiuës përbën një tjetër kufizim të këtij punimi, për vetë faktin e mundësisë së subjektivizmit. Nuk ka pasur vlerësues klinik nga një psikiatër ose psikolog klinik për rastet për të njohur gjendjen e tyre reale, por në këtë rast janë përdorur vetëm pjesëmarrësit të cilët përmbushnin kriteret e përcaktuara në bazë të testit.

Konkluzionet

Relaksimi Progresiv, ka ndikim në reduktimin e ankthit të përgjithësuar dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. Target-grupi i përzgjedhur është i cunguar për të bërë përgjithësime por disa prej rekomandimeve të më poshtme mund të vlejnjë për studime dhe studjues të tjerë. Teknika e *Relaksimit Progresiv* është një nga teknikat e cila vlen të sugjerohet në institucione si spitale, shkolla, deri edhe në kopshte si një teknikë për të ndihmuar individin në përballjen me ankthin dhe stresin e jetësë përditshme.

Nga studimi doli se pjesëmarrësit nuk kishin shumë informacion në lidhje me teknikat të relaksit për këtë arsye, sugjerohet të edukohen dhe të mësohen teknikat e frymëmarrjes dhe të vet-relaksimit, në përshtatje dhe përpuetshmëri me nevojat dhe dëshirat e individit, të cilat do të ndikojnë pozitivisht në mirëqënien fizike e mendore duke rritur nivelin e cilësisë së jetesës dhe performancën profesionale.

Referencat

- Abolghasemi, A., Mehrabizadeh-Honarmand, M., Najarian, B., & Shokrkon, H. (2004). The effectiveness of therapeutic methodology of stress inoculation training and systematic desensitization in test anxiety students. *Journal of Psychology*, 8(29), 3-21.
- Barlow, D. H. (2002). Unravelling the mysteries of anxiety and its disorders from the perspective of emotion theory. *American Psychologist*, 55, 1247-1263.
- Bloom, D.E., Cafiero, E.T., Jané-Llopis, E., Abrahams-Gessel, S., Bloom, L.R., Fathima, S., et al. (2011). *The Global Economic Burden of Noncommunicable Diseases*. Geneva: World Economic Forum.
- Bolden, I. (2008). *Anxiety Disorders among College Students*. [Online] Available: http://www.livestrong.com/health-article/anxiety-disorder-among-collegestudents_9dd271b9-ca2f-2e0e-28eb-a82228bc69bd/ (May 20, 2009).
- BroWn, T. A., Moras, K., Zinbarg, R. E., & BarloW, D. H. (1993). Diagnostic and symptom distinguishability of generalized anxiety disorder and obsessive-compulsive disorder. *Behavior Therapy*, 24, 227–240.
- Chida, Y., Steptoe, A., HirakaWa, N., Sudo, N. & Kubo, C. (2007). The effects of psychological intervention on atopic dermatitis – a systematic review and meta-analysis. *Int Arch Allergy Immunol*; 144: 1–9.
- Conrad, A., & Roth, W.T. (2006). Muscle relaxation therapy for anxiety disorders: It works but how? *Journal of Anxiety Disorders*, 21, 243-264.
- Cramer, V., Torgersen, S. & Kringlen, E. (2005). Quality of life and anxiety disorders: a population study. *The Journal of Nervous and Mental Disease*. 2005/02/25; Vol. 193, issue 3:196–202.
- Demyttenaere, K., Bruffaerts, R., Posada-Villa, J., Gasquet, I., Kovess, V., Lepine, J.P., et al. (2004). Prevalence, severity, and unmet need for treatment of mental disorders in the World Health Organization World mental health surveys. *JAMA*. Vol. 291, issue 21:2581–90. [1538–3598:(Electronic)].

- Dress, R., Ayres, A., & Beechley, B. (2009). The impact of Progressive Muscle Relaxation Training on psychosocial functioning and autonomic recovery and quality of life to stress in addicts. *Inter Journal of applied psychology*, 34(4), 46-68.
- Freeman, L.W., (2001). *Research on mind-body effects*. In: Freeman, L.W., Lawlis, G.F. (Eds.), *Complementary & alternative medicine: A research-based approach*. Mosby, London.
- Greenberg, P.E., Sisitsky, T., Kessler, R.C., Finkelstein, S.N., Berndt, E.R., Davidson, J.R., et al. (1999). The economic burden of anxiety disorders in the 1990s. *The Journal of Clinical Psychiatry*. 1999/08/24; Vol. 60, issue 7:427-35.
- Hoyer, J., Becker, E.S. & Roth, W.T. (2001). Characteristics of worry in GAD patients, social phobics, and controls. *Depression and Anxiety*, 13, 89-96.
- Jacobson, E. (1938). *Progressive relaxation: A psychological and clinical investigation of muscular states and their significance in psychological and medical practice*. Chicago: University of Chicago.
- Karatas, H., Alci, B. & Aydin, H. (2013). Correlation among high school senior students' test anxiety, academic performance and points of university entrance exam. *Educational Research and Reviews*, Vol. 8(13), pp. 919-926, DOI: 10.5897/ERR2013.1462.
- Kerr, K. (2000). Relaxation techniques: a critical review. *Critical Reviews in Physical and Rehabilitation Medicine*, 12, 51-89. Kessler, R., Chiu, W., Demler, O., & Walters, E. (2005). Prevalence, severity, and comorbidity of 12-month DSM-IV disorders in the National Comorbidity Survey Replication. *Archives of General Psychiatry*;62(6):617-27.
- Lambert, M. J., & Bergin, A. E. (1994). *The Effectiveness of Psychotherapy*. In A. E. Bergin & S. L. Garfield (Eds.), *Handbook of Psychotherapy and Behavior Change* (4th ed.). New York: Wiley.
- Lenka, S. K., & Kant, R. (2012). A study of academic anxiety of special need's children in special reference to hearing impaired and learning disabled. *International Journal of Multidisciplinary Research*, Vol.2 (2),64-72.
- Manzoni, G.M., Pagnini, F., Castelnuovo, G., Molinari, E. (2008). Relaxation training for anxiety: a ten-years systematic review with meta-analysis. *BMC Psychiatry*;8:41.
- Margarita, T. (2008). *Depression and Anxiety among College Students*. Psych Central, 12. [Online] Available: <http://psychcentral.com/lib/2008/depression-and-anxiety-among-college-students/> (September 10, 2008).
- McCraty, R., Dana, T., Mike, A., Pam, A., and Stephen, J. (2000). *Improving Test-Taking Skills and Academic Performance in High School Students Using Heart Math Learning Enhancement Tools*. Institute of Heart Math.
- McCraty, R. (2007). *When Anxiety Causes Your Brain to Jam Use Your Heart*. Institute of Heart.
- Mendlowicz, M., & Stein, M. (2000). Quality of life in individuals with anxiety disorders. *Am J Psychiatry*, 157(5), 669-682.
- Nickel, C., Kettler, C., Muelhbacher, M., Lahmann, C., Tritt K., Fartacek, R. et al. (2005). Effect of progressive muscle relaxation in adolescent female bronchial asthma patients: A randomized, double-blind, controlled study. *Journal of Psychosomatic Research*, 59, 393 - 398.
- Ormel, J., Vonkorff, M., Ustun, B., Pini, S., Korten, A. & Oldehinkel, T. (1994). Common Mental Disorders and Disability Across Cultures. *JAMA*. Dec 14;272(22):1741-8.
- Paul, G. L. (1969). Physiological effects of relaxation training and hypnotic suggestion. *Journal of Abnormal Psychology*, 74, 425-437.
- Pavlov, L. A., & Jones, G. E. (2005). The impacted of abbreviated progressive muscle relaxation on salivary cortisol and salivary immunoglobulinA (sIgA). *Applied Psychophysiology and Biofeedback*, 30(4), 375-387.
- Rapaport, M.H., Clary, C., Fayyad, R, & Endicott, J. (2005). Quality-of-life impairment in depressive and anxiety disorders. *The American Journal of Psychiatry*. Vol.162, issue 6:1171-8.
- Rausch, S.M., Gramling, S.E., and Auerbach, S.M. (2006). Effects of single session of large group meditation and progressive muscle relaxation training on stress reduction, reactivity and recovery. *International Journal of Stress Management*, 13 (3), 273-290.
- Ritsner, M.S. & Awad, A.G. (2007). *Quality of Life Impairment in Schizophrenia, Mood and Anxiety Disorders*, Springer. Saarni, S.I., Suvisaari, J., Sintonen, H., Pirkola, S., Koskinen, S., Aromaa, A., et al. (2007). Impact of psychiatric disorders on health-related quality of life: general population survey. *The British Journal of Psychiatry*. 2007/04/03; Vol. 190:326-32.
- Schreiber, E.H. & Schreiber, K.N. (1995). Using relaxation techniques and positive self esteem to improve academic achievement of college students of psychology. *June*76(3): 929-30.
- Schneider, H., MacLennan, & Feeny, D. (2008). Assessment of health-related quality of life in menopause and aging: *Climacteric*; 11, 93-107.
- Spitzer, R. L., Kroenke, K., Williams, J. B. W., & Löwe, B. (2006). A brief measure for assessing generalized anxiety disorder: The GAD-7. *Archives of Internal Medicine*, 166(10), 1092-1097.
- Szabo, S. (1996). *The World Health Organisation Quality of Life (WHOQOL) Assessment Instrument*. NW S. B., *Quality of Life and Pharmacoeconomics in Clinical Trials (2nd edition)*. Philadelphia, New York: Lippincott-Raven Publishers.
- Vickers, A. & Zollman, C. (1999). ABC of complementary medicine. Hypnosis and relaxation therapies. *BMJ*; 20: 1346-1349.
- Wittchen, H., Kessler, R., Beesdo, K., Krause, P., Hoefler, M. & Hoyer, J. (2002). Generalized anxiety and depression in primary care: prevalence, recognition, and management. *Journal of Clinical Psychiatry*;63(Suppl 8):24-34.
- Wolf, D.B., & Abell, N. (2003). Examining the effects of meditation techniques on psychosocial functioning. *Research & Therapy*, 20, 461-467.
- Yılmaz, M., & Ocağcı, A. F. (2010). Bir kız öğrenci yurdunda kalan üniversite öğrencilerinin anksiyete düzeylerinin belirlenmesi [Determination the anxiety level of university students one dormitory located]. *Maltepe Üniversitesi Hemşirelik Bilim ve Sanatı Dergisi*, 3 (1), 16-23.

IDENTIFIKIMI I FAKTORËVE TË SUKSESIT NËKOOPERIMINNDËRORGANIZACIONAL DHE NË NDËRMARRJEN VIRTUALE

ERIND HOTI

Universiteti European i Tiranës

ABSTRAKT

Bashkëpunimet ndërmjet ndërmarrjeve, qofshin ato bilaterale ose në formën e rrjeteve, kanë fituar vëmendje në rritje. Një bashkëpunim ndërmarrjet i përgjigjen kushteve të ndryshueshme të mjedisit të tyre, rritjes së konkurrencës dhe presionit për inovacion. Veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) bashkëpunimi është një alternativë tërheqëse dhe strategjike veprimi, për t'u përballur në mënyrë efektive me problemin e burimeve të kufizuara të ndërmarrjes. Vetëm nëpërmjet bashkimit dhe përdorimit të burimeve të përbashkëta të tilla si njohuritë, eksperiencën, burimet financiare, kapacitetet prodhuese, kanalet e shpërndarjes etj, ndërmarrjet mund të krijojnë sinergji të cilat në rast të kundërt nuk do ishin të disponueshme. Ky punim bazohet në një qasje konceptuale ndaj kooperimit ndërorrganizacional dhe konceptit të ndërmarrjes virtuale duke identifikuar faktorët e suksesit në këtë kontekst.

Fjalë kyç: *Kooperimi ndërorrganizacional, ndërmarrja virtuale, faktor sukcesi*

Hyrje

Pjesëmarrja në rrjete në ditët e sotme është bërë shumë e rëndësishme për çdo ndërmarrje që synon të arrijë një avantazh konkurrues të diferencuar. Kooperimi është një formë e të punuarit së bashku në mënyrë vullnetare e ndërmarrjeve që ka si karakteristikë ndërprerjen e njëanshme (në çdo kohë) së të punuarit së bashku dhe apo braktisjen e partneritetit. Kooperimi ndërorganizacional stimulohet nga fakti që asnjë firmë apo organizatë nuk i ka të gjitha „kapacitetet“, ku bëjnë pjesë burimet dhe aktivitetet e nevojshme për të arritur qëllimet apo objektivat e saja në treg (Hakansson dhe Snehota, 1995).

Fillimisht trajtohen në nivel konceptual kooperimi ndërorganizacional, ballafaqohen ngjashmëritë dhe diferencat ndërmjet termave kooperim, bashkëpunim apo rrjetëzim i koordinuar dhe rrjetëzim që të tërhiqet vëmendja ndaj konceptit të rrjeteve bashkëpunuese. Larmia e formave të tyre përfshin ndër të tjera organizatat virtuale të orientuara drejt shërbimit apo prodhimit, ndërmarrjen virtuale etj. Punimi pozicionon konceptin e ndërmarrjes virtuale në kontekst, dhe përpiket të identifikojë elementët thelbësorë që ndikojnë në arritjen e suksesit në kooperimin ndërorganizacional dhe ndërmarrjen virtuale duke përdorur si konstrukt metodologjik evidentimin e “faktorëve të suksesit”.

Metodologjia

Termi “faktor sukcesi” identifikohet me punën e Daniel (1961). Pikënisja e punës së tij kërkimore ishte nevoja e menaxherëve për të zvogëluar shumëllojshmërinë e të dhënave dhe pasja në dispozicion e informacionit kyç për menaxhimin e kompanisë. Njëpërmjet «success factors» synohet që plotësimi i nevojave të nivelit menaxherial për informacion të përqendrohet në ato faktorë që kontribuojnë ndjeshëm tek sukcesi (Daniel, 1961, fq. 111ff). Puna kërkimore rreth faktorëve të suksesit thekson se, pavarësisht shumë dimensionalitetit dhe shumë shkakësisë të suksesit, tek një ndërmarrje ekzistojnë faktorë qendrorë që ndikojnë ndjeshëm tek sukcesi (Leidecker dhe Bruno, 1984, fq. 23-32).

Qëllimi i punës hulumtuese rreth faktorëve të suksesit është mbledhja dhe sistematizimi i të gjithë variabileve ose faktorëve të mundshëm për të përcaktuar ndikimin e tyre mbi suksesin, pra gjetjen e atyre faktorëve që kualifikohen si kritikë për suksesin e kompanisë (Bürgel dhe Zeller, 1997, fq. 220).

Siç shprehet Rockart (1979), ato përfaqësojnë fushat e pakta kyçe ku «gjërat duhet të shkojnë mirë» në mënyrë që biznesi të lulëzojë. Duke iu referuar argumenteve pioniere të Daniels, Rockart përcakton si vijon termin «faktor kritik sukcesi»: «faktorët kritikë të suksesit janë, për çdo biznes, numri i kufizuar i fushave në të cilat rezultatet, në qoftë se janë të kënaqshme, do të sigurojnë performancë konkurruese të suksesshme për organizatën (Rockart, 1979, fq. 85).

Fokusi mund të përqendrohet në identifikimin e faktorëve të suksesit që kanë të bëjnë me fusha të veçanta funksionale, ose me ndërmarrjen si e tërë. Puna kërkimore e bazuar në faktorët e suksesit mund të përfshijë të gjitha ndërmarrjet e sektorëve të ndryshëm, sektorë specifik, të kufizohet më specifikisht në kategori të caktuara të ndërmarrjeve, ose bërjen e analizës së faktorëve të suksesit qoftë edhe për një ndërmarrje të vetme. Si mangësi të kësaj qasjeje, March dhe Sutton (1997, fq. 699) konstatojnë se përhapja e dijes rreth faktorëve të suksesit i bën këta të fundit të padobishëm dhe se zbulimi i faktorëve të suksesit është vetëm atëherë i dobishëm kur konkurrenca nuk ka njohuri paraprake të tyre. Prandaj faktorët e suksesit kanë një lloj vetie vetë-shkatërruese pasi me përhapjen e dijes rreth tyre, faktorët që fillimisht bënin diferencën ndërmjet performuesve të lartë dhe performuesve të dobët tentojnë të zhduken. Gjithashtu, sa më e fuqishme që besohet të jetë aftësia e tyre shpjeguese aq më shpejt përhapet dija rreth tyre. Megjithatë pavarësisht nga mangësitë që shfaq, kërkimi shkencor i bazuar në faktorët e suksesit konsiderohet shpesh i rëndësishëm në kërkimin organizacional dhe menaxherial.

Dallimet ndërmjet termave në varësi të maturitetit të bashkëveprimit

Më poshtë lind nevoja të bëjmë dallimin e termave kooperim, bashkëpunim, rrjetëzim i koordinuar dhe rrjetëzim që shpesh përdoren në mënyrë ekuivalente ose pa qenë të vetëdijshëm se çfarë saktësisht përfaqëson secili term por që në të vërtetë i referohen varësive të ndryshme të maturitetit të bashkëveprimit ndërmjet entiteteve pjesëmarrëse.

Kooperimi

Kooperimi nuk përfshin vetëm komunikimin, shkëmbimin e informacionit dhe përshtatjen e aktiviteteve, por gjithashtu ndarjen e burimeve për arritjen e objektivave. Kooperimi arrihet njëpërmjet ndarjes së punës (jo tepër të detajuar) ndërmjet pjesëmarrësve. Në këtë rast vlera e agreguar është rezultati i mbledhjes së “komponentëve” individuale të vlerës së gjeneruar në një mënyrë thujse të pavarur nga pjesëmarrësit e veçantë. Një zinxhir tradicional furnizimi i bazuar në lidhjet klient-furnitor dhe me role të parapërcaktuara në zinxhirin e furnizimit, është një shembull i një procesi kooperues. Çdo pjesëmarrës kryen pjesën e tij të punës, në një mënyrë thujse të pavarur (edhe pse të koordinuar me të tjerët). Megjithatë, ekziston një plan i përbashkët që në më të shumtën e rasteve nuk është përkufizuar bashkërisht, por është dizenuar nga një entitet i vetëm dhe kërkon punë të përbashkët në rastin kur rezultatet i dërgohen partnerit. Sidoqoftë objektivat e tyre janë kompatibël çfarë do të thotë se rezultatet mund të mbliidhen apo të kompozohen në një zinxhir vlere për të ofruar produktin apo shërbimin përfundimtar.

Kooperimi duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme që të mos jetë në kundërshtim me ligjin e konkurrencës:

Kooperimi duhet të ketë për qëllim ti shërbejë racionalizimit të aktiviteteve ekonomike.

Nuk duhet të ndikojë ndjeshëm konkurrencën në treg.

Përfshin rënien dakord me kontratë mes ndërmarrjeve.

Formimi i aleancave kooperuese dhe bashkëpunuese mundëson konkurrencë më të efektshme ndaj grupeve ose subjekteve të tjera. Kjo zakonisht është arsyeja pse NVM-të kooperojnë, pasi i mundëson atyre mbijetesën në tregje të turbullta. Në natyrë gjenden gjithashtu aleanca natyrore që konkurrojnë me të tjera për mbijetesë (Kangas, 2005). Sa më i fortë është kërcënimi aq më i lartë është kohezioni i brendshëm dhe ndjenja e identitetit të grupit.

Në vitin 2003, Observatori European i NVM-ve publikoi një studim të detajuar mbi NVM-të dhe bashkëpunimin, që bazohet në hulumtime të kryera nga Rrjeti European për Kërkime në NVM (ENSR) dhe Intromart. Të dhënat empirike bazohen në 7.745 intervista të NVM-ve në Europë duke mundësuar një interval besueshmërie (konfidencë) më të madh se 95%. Gjetjet e këtij studimi, ndër të tjera theksojnë se bashkëpunimi është një fenomen shumë i zakonshëm, ku gjysma e NVM-ve europiane bashkëpunojnë me njëra-tjetrën. Megjithatë, ka ende shumë potencial pasi gjysma tjetër e NVM-ve nuk janë të përfshira në bashkëpunim. Studimi tregon se 25% prej 19.27 milionë NVM-ve në 19 vendet e BE ku u krye studimi janë të përfshira në kooperime formale, 65% e NVM-ve kooperuese kanë më shumë se dy partnerë dhe se 80% e partneriteteve ndërmjet NVM-ve ekzistojnë më shumë se tre vjet (ESNR & Intromart, 2003).

Propozimet e shumta mbi përkufizimin dhe të kuptuarit e termit kooperim vijnë edhe për shkak të përzierjes së terminologjisë në gjuhë të ndryshme (p.sh: terma të ndryshëm në gjuhën angleze, gjermane etj.). Shembuj termash dhe konceptesh për përshkrimin e fenomenit të kooperimit janë ndër të tjera (Rautenstrauch et, al. 2003, fq. 7):

- Alliance Network
- Co-operative Agreement
- Competitive Cooperation
- Collaborative Agreement/Arrangement
- Cooperative Venture
- Integration
- International Corporate Linkages
- Joint Venture
- Strategic Partnership
- Virtual Corporation
- Virtual Network
- Working Partnership

Një nga arsyet për këtë terminologji jo-uniforme është fakti se koncepti i kooperimit përdoret në një shumëllojshmëri disiplinash shkencore. Bien veçanërisht në sy citimet e shumëfishta nga fusha e ekonomisë por edhe dhe atë të psikologjisë apo të sociologjisë, duke u reflektuar si rrjedhojë edhe në të folurën e përditshme (Mellewigt, 2003, fq. 8). Nisur nga larmia e propozimeve mbi përkufizimin e termit kooperim nuk mund të jepet një definicion i vetëm i tij. Megjithatë, kooperimi ka dy karakteristika përbërëse (Kraege, 1997), (Mellewigt, 2003, fq. 9.):

- Varësi reciproke (ndërvarësi)
- Autonomi/pavarësi e ndërmarrjeve kooperuese


Bazuar në përkufizimin juridik, kooperimet ndërmjet ndërmarrjeve karakterizohen nga koordinimi dhe përmbushja e përbashkët e detyrave, ku secila prej kompanive të përfshira në kooperim ruan pavarësinë e saj ligjore dhe ekonomike. Aspekte të tjera janë p.sh natyra vullnetare e të punuarit së bashku, qëllimet e përbashkëta të kooperimit dhe motivimi për të kooperuar.

Në varësi të nivelit të bashkëveprimit, ekzistojnë disa kritere për diferencimin ndërmjet termave të ngjashëm me termin kooperim dhe që shpesh përdoren në mënyrë ekuivalente por që në fakt nuk nënkuptojnë të njëjtën gjë. Ndërkohë që gjatë kooperimit zgjidhjet e pjesshme të prodhuara në mënyrë paralele kombinohen për të ofruar një zgjidhje të vetme, gjatë bashkëpunimit, krijohet një zgjidhje e integruar gjatë një procesi të përbashkët zgjidhjeje.

Bashkëpunim, rrjetëzim i koordinuar dhe rrjetëzim

Vetë fjala bashkëpunim ka prejardhje nga latinishtja “collaborare” që do të thotë “të punosh së bashku” dhe mund të konsiderohet si një proces krijimi i përbashkët që përfshin ndarjen e riskut, burimeve, përgjegjësi, humbjeve dhe përfitimeve. Entitetet bashkëpunuese mund ti japin një vëzhguesi të jashtëm imazhin e një identiteti të përbashkët. Bashkëpunimi përfshin angazhimin reciprok të pjesëmarrjeve për të zgjidhur së bashku një problem, një iniciativë që kërkon besim reciprok si dhe kohë, përpjekje dhe dedikim. Kontributet individuale në krijimin e vlerës gjatë bashkëpunimit janë shumë më të vështira për tu përcaktuar se në rastin e kooperimit. P.sh: një proces bashkëpunimi mund të ndodhë gjatë një procesi inxhinierik ku një skuadër ekspertësh zhvillon bashkërisht një produkt të ri.

Ne këtë rast edhe pse nevojitet një lloj koordinimi, për shkak të specifikës së krijimit të përbashkët, bashkëpunimi mund të përfshijë dhe pikëpamje divergjente dhe spontane që nuk i përmbahen një strukture të caktuar. Si nivele më të ulëta maturiteti në bashkëpunim identifikohen më pas “rrjeti i koordinuar” që shërben për komunikim dhe shkëmbim informacioni si dhe kompatibilitetin e objektivave (përshtatjen e aktiviteteve për përfitim reciprok) si dhe “rrjeti” që shërben në mënyrë bazike për komunikim dhe shkëmbim informacioni. Camarinha-Matos dhe Afsarmanesh (2006) paraqesin grafikisht dallimin mes termave bashkëpunim, kooperim, rrjetëzim i koordinuar si dhe rrjetëzim siç ilustron në grafikun më poshtë:



Burimi: Niveli i maturitetit i bashkëpunimit bazuar tek (Camarinha-Matos dhe Afsarmanesh, 2006).

Rrjetet e ndërmarrjeve

Rrjetet e ndërmarrjeve janë «një formë organizimi e aktivitetit ekonomik që synon arritjen e avantazheve konkurruese që karakterizohen nga lidhje komplekse-reciproke, me tepër kooperuese se konkurruese dhe relativisht stabile ndërmjet ndërmarrjeve juridikisht të pavarura dhe ekonomikisht të ndërvarura» (Rautenstrauch et al., 2003, fq. 23).

Ato krijohen veçanërisht në industri që ballafaqohen me ndryshim të shpejtë teknologjik, konkurrencë intensive, kërkesa heterogjene të konsumatorëve dhe standarde të formalizuara (Sydow dhe Duschek, 2011, fq. 60). Objektivat e përbashkëta të rrjetit janë komponentë thelbësorë të rrjeteve. Rrjeti përbën në njëfarë mënyre platformën e komunikimit për të gjetur një ekuilibër mes gjenerimit të ideve dhe zbatimit të tyre, si dhe ruajtjes së strukturës dhe arritjes së fleksibilitetit. Rrjetet ekzistojnë si pasojë e shkëmbimit të shërbimeve plotësuese ku për aq kohë sa shkëmbimi/ndërveprimi është tërheqës për partnerët, rrjeti vazhdon të ekzistojë (Kowatsch, 2005).


Rrjetet e bashkëpunimit

Rrjetet e bashkëpunimit përfaqësojnë një paradigme që ka fituar vëmendje në rritje në vitet e fundit si pasojë e zhvillimeve të vrullshme në biznes dhe në shoqërinë e dijes (Camarinha-Matos dhe Afsarmanesh, 2005). Sipas Camarinha-Matos dhe Afsarmanesh (2005) këto rrjete mbështesin krijimin e formave të reja organizacionale si zinxhirë furnizimi shumë të integruar dhe dinamikë, ndërmarrje të zgjeruara e virtuale, komunitetet profesionale virtuale, të cilat janë vetëm disa nga shembujt e këtij trendi të nxitur nga teknologjitë e informacionit dhe komunikimit. Edhe pse jo të gjitha, shumica e formave të rrjeteve bashkëpunuese nënkuptojnë një lloj organizimi të aktiviteteve të pjesëmarrësve në to, duke identifikuar rolet për pjesëmarrësit dhe disa rregulla të qeverisjes. Pjesëmarrja në të tilla rrjete bashkëpunimi mund të sjellë përfitime entiteteve të përfshira në to duke i mundësuar atyre arritjen e objektivave të përbashkëta si akses në tregje më të gjëra e dije të reja, ndarje të riskut dhe të burimeve, bashkim aftësish dhe kapacitetesh komplementare që lejojnë çdo entitet të fokusohet në kompetencat e veta thelbësore duke ruajtur njëkohësisht një nivel të lartë agjiliteti, etj. Sa i përket agjilitetit, format e reja organizacionale nxisin inovacionin dhe kështu krijimin e „vlerës së re“ duke konfrontuar dije dhe praktika apo kombinuar burime dhe teknologji si dhe krijimin e sinergjive.

Organizatat Bashkëpunuese në Rrjet (CNOS): janë të orientuara drejt qëllimit të përbashkët dhe ku praktikohet bashkëpunim intensiv mes partnerëve, në ndryshim nga aleancat strategjike afatgjata, ku në fakt në to nuk praktikohet bashkëpunimi, por kooperimi mes partnerëve (Camarinha-Matos et al., 2009, fq. 4).

Mjedisi Kultivues i Organizatës Virtuale (VO Breeding Environment - VBE): përfaqëson një grupim të organizatave dhe institucioneve të tyre mbështetëse, që i qëndrojnë respektimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi afatgjatë, dhe adaptimit të një infrastrukture dhe parimeve operative të përbashkëta, me qëllim kryesor rritjen e gatishmërisë së tyre për tu konfiguruar shpejt në aleanca të përkohshme bashkëpunimi. Domethënë, kur një anëtar (që vepron si një ndërmjetës apo broker) identifikon një mundësi biznesi, një nëngrup që është pjesë e VBE mund të përzgjidhet për të formuar një Organizatë Virtuale (OV) apo Ndërmarrje Virtuale (NV) (Camarinha-Matos at al. 2009, fq. 5). Por më parë lind nevoja të kuptojmë çfarë është dhe si funksionon ndërmarrja virtuale.

GRAFIKU: LIDHJA DHE DALLIMET MIDIS RRJETEVE STRATEGJIKE DHE RRJETEVE TË ORIENTUAR DREJT OBJEKTIVIT OSE MUNDËSISË SË SHFAQUR



Burimi: Autori, ilustrimi i bazuar tek (Camarinha-Matos dhe Afsarmanesh, 2012)

Ndërmarrja virtuale

Ndërmarrja virtuale është një lloj përgjigjeje organizative ndaj dinamikës dhe globalizimit të tregjeve të sotme. Pikënisja për një ndërmarrje virtuale është nevoja e konsumatorëve. Këto nevoja mund të jenë të gjëra dhe unike (p.sh. një kontratë e bazuar në një projekt të madh), apo të vogël, por me variacione të shumta. Për shembull, një numër kompanish komplementare të specializuara në riparimin dhe mirëmbajtjen e sendeve shtëpiake mund të formojnë një ndërmarrje virtuale për të ofruar një shërbim të plotë për klientët e saj potencial. Këto shërbime mund të përfshijnë ruajtjen e strukturës së shtëpisë, të gjitha format e furnizimeve të energjisë, lidhjet e telekomunikacionit, riparim/mirëmbajtjen e objekteve të familjes si sobave, makinave larëse, pajisjeve ngrirëse dhe të riciklimit të mbeturinave. Secili prej këtyre shërbimeve kërkon kompetenca unike thelbësore. Kështu, disa ndërmarrje të vogla të specializuara mund të rrisin bazën e tyre të klientëve potencial duke bashkuar kompetencat e tyre. Atraktiviteti për klientin e një ndërmarrjeje të tillë do të jetë se do të ballafaqohet vetëm një pikë të vetme kontakti për shumicën e problemeve që lidhen me aspekte të mirëmbajtjes së shtëpisë.

Nisur nga sa u argumentua më sipër vihet re se për formimin e ndërmarrjes virtuale është i nevojshëm grupimi i më shumë se një kompetence bazë. Po ta shikosh hollë, nuk ka asgjë të re në kompanitë e vogla që kanë bashkuar forcat për të forcur pozicionimin e tyre në treg, përveç disponueshmërisë së teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) që i ka dhënë ndërmarrjeve të vogla platforma krejtësisht të reja për të bashkëpunuar në mënyrë efikase duke furnizuar në mënyrë efektive produktet/shërbimet. Kështu, duhet të theksohet se TIK përbën teknologjinë mundësuese dhe kushtin e domosdoshëm (ndonëse jo të mjaftueshëm) për ekzistencën e një ndërmarrje virtuale.

Partnerët e biznesit në ndërmarrjet virtuale mund të ruajnë agjilitetin individual për të ndërmarrë operacionet e tyre të biznesit dhe ndoshta në të njëjtën kohë të marrin pjesë në projekte të tjera ndërmarrjesh të zgjeruara ose NV (Jagdev, 1998).


Disa autorë i përcaktojnë ndërmarrjet virtuale si një rrjet i përkohshëm ndërmarrjesh të pavarura të angazhuara në ofrimin e një produkti apo shërbimi. Childe (1998) përcakton evolucionin e ndërmarrjes virtuale: dhe «... në ekstrem, ndërmarrja kryesore mund të mos ketë asnjë premisë dhe mund të mos kryejë atë që përgjithësisht konsiderohet si punë prodhuese – duke u përbërë vetëm nga funksione të tilla si projektim dhe menaxhim prodhimi, duke vepruar si koordinator i aktiviteteve mes ndërmarrjeve kooperuese. Në këtë rast, ndërmarrja bëhet një “ndërmarrje virtuale”, duke iu paraqitur klientëve të saj si një furnizuese e mallrave dhe shërbimeve, por pa ushtruar veprimtari të brendshme prodhimi». Në të tilla raste, ndërmarrjet virtuale janë shpesh të bazuara në projekte dhe zakonisht operojnë në tregje të reja niche. Kështu ato formohen, reformohen

dhe shpërbëhen në bazë të dinamikës së tregut dhe mundësive që tregu i ofron.

Forbairt (Forbairt, 1996) përshkruan një ndërmarrje virtuale si një përgjigje ndaj shpejtësisë dhe globalizimit në epokën dixhitale. Kjo është një ndërmarrje që mund të mos ketë asnjë zyrë qendrore fizike apo qendër, shumë pak punëtorë me kohë të plotë dhe që ekziston si një kombinim aftësish dhe kompetencash të veçanta nga individë apo ndërmarrje.

Një ndërmarrje virtuale mund të jetë ngritur me qëllim ofrimin e një lloji të veçantë produkti apo shërbimi. Kur tregu për këtë produkt apo shërbimit shënon rënie, ndërmarrja virtuale shkrihet dhe anëtarët e saj kërkojnë të gjejnë partnerë të rinj. Në fshatin global ndërmarrjet që mbijetojnë dhe avancojnë janë të shkathëta, fleksibël dhe të adaptueshme si dhe vazhdimisht në kërkim për të maksimizuar avantazhet e tyre unike. Krahasuar me një ndërmarrje origjinale, sipas Scholz (Scholz, 1997), një ndërmarrje virtuale karakterizohet gjithmonë nga mungesa e attributeve/karakteristikave fizike të veçanta të tilla si një administrim i përbashkët ose një status ligjor i përbashkët. Këto karakteristika janë zëvendësuar nga aplikimi i infrastrukturave të sofistikuar të informacionit dhe të komunikimit dhe besimit reciprok (mirëkuptimit të përbashkët).

GRAFIKU: FORMAT E KOOPERIMIT DHE FOKUSI I KËTIJ PUNIMI.



Burimi: Autori

Kulturë rrjeti në vend të kulturës së ndërmarrjes

Suksesi i një ndërmarrje tradicionale lidhet ngushtë me përbrendësimin për një kohë të gjatë të kulturës së ndërmarrjes, pra të vlerave dhe të asaj çfarë një ndërmarrje beson, si dhe ndarjen e këtyre cilësive me palë të tjera. Paradigma e një kulture të fortë ndërmarrje nuk është kompatibël me ndërmarrjen virtuale për dy arsye: nga njëri aspekt një kulturë e fortë ndërmarrje apo “të jesh ndryshe” paraqet barrierë për rrjetëzimin duke vështirësuar integrimin me ndërmarrjet e tjera pjesëmarrëse në rrjet. Nga ana tjetër ndërmarrjet virtuale (të cilat shpeshherë janë të orientuara drejt projekteve) kanë një cikël jete të kufizuar dhe i mungon koha që të ndërtojnë një kulturë analoge me kulturën e ndërmarrjes. Për këtë arsye kultura e rrjetit ka një tjetër qasje (p.sh. kulturë projekti në vend të kulturës së një ndërmarrjeje familjare) (Reiß, M., 2006). Nisur nga specifikat e veçanta të kooperimit në rrjet, është e rëndësishme përcaktimi i faktorëve që bën të suksesshme pjesëmarrjen në rrjete dhe format e tilla organizacionale si rasti i ndërmarrjes virtuale.

Faktorët e suksesit në kooperimin ndërorganizacional dhe të ndërmarrjes virtuale

Në vijim, do paraqesim faktorët e suksesit të identifikuar në literaturën për kooperimin dhe ndërmarrjen virtuale siç u përmend që në fillim. Termi “suksesi” duhet të interpretohet si njësi shumëdimensionale i përbërë nga ndërveprimi optimal i shumë elementëve përcaktues dhe përshtatja e tyre me kushtet e jashtme. Prandaj është e nevojshme të shqyrtohen faktorët që ndikojnë pozitivisht në suksesin e ndërmarrjes dhe problemet që mund të ndeshen në përfshirjen në një marrëdhënie kooperuese apo krijimin e ndërmarrjeve virtuale. Rautenstrauch (2003) evidenton si faktor suksesi për kooperimet dhe rrjetet në përgjithësi të qenurit i hapur, ndershmërinë, besimin, konvergencën e objektivave/interesave, ngjashmërinë e partnerëve dhe përfitimet reciproke. Në të kundërt evidenton si faktorë problematikë mungesën e informacionit, mungesën/ndryshimet e objektivave, mungesën e besimit, divergjencën e partnerëve si dhe konkurrencën mes tyre (Rautenstrauch et al., 2003, fq 82-84). Nga ana tjetër Tjaden (2003) paraqet të renditura sipas rëndësisë dhe fazave të ndryshme që kalon ndërmarrja virtuale, faktorët e suksesit si: aftësinë rrjetëzuese të partnerit, përshtatjen e partnerëve, krijimin e një bazamenti të fortë

në marrëdhënien bashkëpunuese, përcaktim të qartë të objektivave, organizimin ligjor të bashkëpunimit, përparësitë nga kooperimi, sjelljen kooperuese (Tjaden, 2003).

Më poshtë paraqiten në formë tabelore në mënyrë më të detajuar faktorët e evidentuar të suksesit në rastin e kooperimit ndërorganizacional dhe ndërmarrjes virtuale:

TABELA 1: FAKTORËT E SUKSESIT NË KOOPERIMIN NDERORGANIZACIONAL DHE TË NDËRMARRJES VIRTUALE

Faktorët e suksesit në kooperimin ndërorganizacional		Faktorët e suksesit në ndërmarrjen virtuale	
Përmbajtja e kooperimit	<ul style="list-style-type: none"> Njohja e kufijve të kooperimit Përcaktim i qartë i limiteve të iniciativës kooperuese Arrija e përmirësimit të performancës në treg Të mwsuarit nga kooperimi dhe me kooperimin Formulimi dhe rënia dakord sa më herët mbi objektivat e kooperimit Rezultat pozitiv për të gjithë pjesëmarrësit në kooperim Marrja parasyshe e ndërvarësisë mes formave të ndryshme të kooperimit 	Cilësia e partnerit	Përvoja kooperuese, gatishmeria në princip për të kooperuar dhe mesuar, besueshmeria pa kushte, aftësi thelbësore komplementare
		Profesionaliteti	Profesionaliteti i ngjashëm, kompatibiliteti i përvojave, vlerave, principeve dhe pritshmerive të ardhshme, lidhje të mira me nivelet menaxheriale të partnerit, distance e vogël kulturore
		Përgjegjësi objektive	Qëllime strategjike kompatible, përkufizimi i objektivave të ndërmarrjes virtuale dhe pritshmerive ndaj partnerit pjesëmarrës
Forma e kooperimit	<ul style="list-style-type: none"> Përcaktimi i nivelit të organizimit dhe lidhjes në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e aktivitetit për të cilin kooperohet Sjellje që mbështet kooperimin Ruajtja e fleksibilitetit Mundësi e vendosjes së sanksioneve Menaxhim dhe kontroll i përbashkët i kooperimit Funksione dhe dhënie e qartë kompetencash si dhe konsens mbi rolet Besim i ndërsjellët si bazë për kooperimin Përcaktim kriteresh për pritshmërinë, matjen dhe ndarjen e suksesit Kontrata si bazë për kooperimin Formë organizimi eficiente për kooperim Burimet njërëzore Angazhimi i vazhdueshëm i burimeve cilësore në kooperim Komunikim dhe informim nga brënda dhe jashtë Numri i pjesëmarrësve në kooperim (madhësia e grupit kooperues) Kapitali i sjellë nga pjesëmarrësit 	Rregullatë partnerit	Situatë ein-ein afatgjatë për të dy partnerët, përgjegjësia për vendimmarrjen, rregullat e daljes, menaxhimi i konfliktit, heqja dorë
		Bashkëpunimi i përbashkët	Domethënie e barabartë e të gjithë partnerëve, jo qëllime dominuese të një partneri
		Informimi i përgjegjësive	Qartësia e përgjegjësive, humbje e vogël (mosekzistente) në pikëtakimin e përgjegjësive të dy partnerëve, delegim i
		Cilësia bashkëpunimit	Ndërtimi i një "corporate identity" të ndërmarrjes virtuale, bashkëpunim i partnerëve direkt në një nivel të ulët të hierarkisë, cilësia e punonjësve dhe e menaxhimit, stili i komunikimit me partnerin
		Informimi bashkëpunimit	Qëllim i mirëpërcaktuar, transparencë nëpërmjet proceseve të udhëheqjes në sistem, ekzistenca e një koordinatori, TIK, komunikim i hapur dhe i rregullt, pavarësia ekonomike e partnerit, ndërtimi i besimit (personalisht), ekzistenca e një kompetencë thelbësore ekselente e partnerit
		Informimi bashkëpunimit	Besueshmëria mbi kompetencat bazë dhe burimet e partnerit, ndërtimi i marrëdhënieve sociale

Burimi: Autori (bazuar në literaturën e rishikuar)

Konkluzione

Pas trajtimit të karakteristikave të kooperimit ndërorganizacional, punimi ballafaqon ngjashmëritë dhe diferencat ndërmjet termave kooperim, bashkëpunim, rrjetëzim i koordinuar dhe rrjetëzim si dhe tërheq vëmendjen rreth konceptit të rrjeteve bashkëpunuese. Larmia e formave të tyre përfshin ndër të tjera edhe ndërmarrjen virtuale. Punimi pozicionon konceptin e ndërmarrjes virtuale në kontekst, dhe identifikon elementët thelbësorë që ndikojnë në arrijten e suksesit në kooperimin ndërorganizacional dhe ndërmarrjen virtuale duke përdorur si konstrukt metodologjik evidentimin e "faktorëve të suksesit". Faktorët e suksesit të kooperimit ndërorganizacional i ndajmë në faktorë që kanë të bëjnë me përmbajtjen dhe format e kooperimit. Në lidhje me përmbajtjen e kooperimit ndërorganizacional si faktor sukcesi identifikohen ndërvarësitë, kufijtë, objektivat, rezultati, performanca, të mësuarit dhe limitet e kooperimit. Ndërsa faktorët e suksesit që lidhen me format e kooperimit ndërorganizacional kanë të bëjnë me madhësinë dhe kompleksitetin, sjelljen, fleksibilitetin, qartësinë e roleve, besimin e ndërsjellët, menaxhimin dhe kontrollin e përbashkët, pritshmëritë dhe ndarjen e suksesit, kontratën, cilësinë e burimeve njerëzore, komunikimin dhe informimin, kapitalin, menaxhimin e konfliktit, madhësinë e grupit kooperues dhe eficientë e formës së zgjedhur të kooperimit. Ndërsa në rastin e ndërmarrjes virtuale faktorët e suksesit kanë të bëjnë me

cilësinë dhe përshtatshmërinë e partnerit, përputhjen e objektivave, rregullat e qarta të lojës, bashkëpunimin në partneritet, ndarjen e qartë të përgjegjësiave, cilësinë dhe bazat e bashkëpunimit dhe besueshmërinë ndërmjet partnerëve. Përdorimi i faktorëve të suksesit kritikohet si metodologji ngaqë arritja e suksesit në biznes nuk mund të atribuohet faktorëve të veçantë e individual të suksesit por që sukcesi i një ndërmarrje përcaktohet nga një sërë variablesh të ndërvarura dhe se efektiviteti i variabëve të veçanta në arritjen e suksesit nuk mund të izolohet (parimi i shkakësisë të shumëfishtë). Megjithatë pavarësisht nga mangësitë që shfaq, kërkimi shkencor i bazuar në faktorët e suksesit konsiderohet shpesh i rëndësishëm për kërkimin organizacional dhe menaxherial.

Literatura

- Arnold, O., Faisst, W., Härtling, M., & Sieber, P. (1995). Virtuelle Unternehmen als Unternehmenstyp der Zukunft. *Handbuch der modernen Datenverarbeitung*, 32(185), 8-32. Marrë nga: http://www.econbiz.de/archiv/er/uer/bwinformatik1/virtuelle_un_un-tyt.pdf
- Balling, R. (2012). *Kooperation: Strategische Allianzen, Netzwerke, Joint Ventures und andere Organisationsformen zwischenbetrieblicher Zusammenarbeit in Theorie und Praxis*. Lang, Peter, Internationaler Verlag der Wissenschaften.
- Bürgele, H. D., & Zeller, A. (1997). Controlling kritischer Erfolgsfaktoren in der Forschung und Entwicklung. *Controlling*, 9(4), 218-225.
- Camarinha-Matos, L. M., & Afsarmanesh, H. (2012). Taxonomy of collaborative networks forms: FInES Task Force on Collaborative Networks and SOCOLNET-Society of Collaborative Networks. Marrë nga: <http://dare.uva.nl/document/2/127759>
- Camarinha-Matos, L. M., Afsarmanesh, H., Galeano, N., & Molina, A. (2009). Collaborative networked organizations—Concepts and practice in manufacturing enterprises. *Computers & Industrial Engineering*, 57(1), 46-60. Marrë nga: http://www.researchgate.net/profile/Hamideh_Afsarmanesh/publication/220384416_Collaborative_networked_organizations_-_Concepts_and_practice_in_manufacturing_enterprises/links/0deec51fd75f130b2f000000.pdf
- Camarinha-Matos, L.M. and Afsarmanesh, H. (2006). “Collaborative Networks: Value Creation in a Knowledge Society” in K. Wang et al (Eds.), *Knowledge Enterprise: Intelligent Strategies in Product Design, Manufacturing and Management*, International Federation for Information Processing (IFIP), Vol. 207, pp. 26-40, New York: Springer Publisher.
- Camarinha-Matos, L. M., & Afsarmanesh, H. (2005). Collaborative networks: a new scientific discipline. *Journal of intelligent manufacturing*, 16(4-5), 439-452.
- Childe, S. J. (1998). The extended concept of co-operation. *Production Planning & Control*, 9(4), 320-327.
- Daniel, D. R. (1961): *Management Information Crisis*, in: HBR, September/Oktober 1961
- Dewett, Todd; Jones, Gareth: The role of information technology in the organization – a review, model, and assessment, *Journal of Management*, 27 (2001) 3, P. 313-346
- Forbairt (1996): “Virtual Corporation Defined, Summary Section for Forbairt Internet Report, Forbairt, Ireland.
- Helm, R., & Peter, A. (1999). Erfolgsfaktoren von Joint Ventures: Ergebnisse der bisherigen empirischen Forschung und deren qualitative Prüfung. *Zeitschrift für Planung: ZP= Journal of planning*, 10, 27-46.
- Jagdev, H. S., & Thoben, K. D. (2001). Anatomy of enterprise collaborations. *Production planning & control*, 12(5), 437-451. Marrë nga: http://www.researchgate.net/profile/Klaus-Dieter_Thoben/publication/37933517_Anatomy_of_Enterprise_Collaborations/links/545949e10cf2cf516483ce82.pdf
- Kangas, S. (2005). Spectrum five: Competition vs. cooperation. In: *The long FAQ of Liberalism*, <http://www.huppi.com/kangaroo/LiberalFAQ.htm#Backspectrumfive>
- KMU in Europa. Beobachtungsnetz der europäischen KMU in Zusammenarbeit mit European Network for SME Research (ESNR) und Intromart, URL: http://ec.europa.eu/enterprise/enterprise_policy/analysis/doc/smes_observatory_2003_report7_de.pdf, Nr. 7, 2003
- KMU und Kooperationen, Beobachtungsnetz der europäischen KMU in Zusammenarbeit mit European Network for SME Research (ESNR) und Intromart, URL: http://ec.europa.eu/enterprise/enterprise_policy/analysis/doc/smes_observatory_2003_report5_de.pdf, Nr.5, 2003
- Kowatsch, B. (2005): Erfolgsfaktor Netzwerke. Neue Perspektiven für kleine und mittelständische Unternehmen, VDM Verlag Dr. Müller, Berlin
- Kraege, R. (1997). *Controlling strategischer Unternehmenskooperationen: Aufgaben, Instrumente und Gestaltungsempfehlungen*. München und Mering: Rainer Hampp Verlag. Marrë nga: <http://www.econstor.eu/bitstream/10419/116849/1/3-87988-212-6.pdf>
- Leidecker, Joel K.; Bruno, Albert V. (1984): Identifying and Using Critical Success Factors, in: *Long Range Planning*, 17. Jg., Nr. 1/1984, S. 23-32
- March, J. G.; Sutton, R. I. (1997): Organizational performance as a dependent variable. In: *Organization Science*, 6. Jg (1997), Fq. 698–706. Marrë nga: <http://www.wiggo.com/mgmt8510/Readings/Readings3/march1997orgsci.pdf>
- Mellewig, T. (2003). *Management und Erfolg von Strategischen Kooperationen: Eine ressourcenorientierte Betrachtung*. In *Management von Strategischen Kooperationen* (pp. 51-148). Deutscher Universitätsverlag. Marrë nga: <https://books.google.de/books?hl=de&lr=&id=DNumsSGJ5QwC&oi=fnd&pg=PR15&dq=Management+von+Strategischen+Kooperationen&ots=gXHFy8wEMC&sig=hrOepwWN0qVfyu3ENAv-Dkv3VqY#v=onepage&q=Management%20von%20Strategischen%20Kooperationen&f=false>
- Rautenstrauch, T., Generotzky, L., & Bigalke, T. (2003). *Kooperationen und Netzwerke. Grundlagen und empirische Ergebnisse*, Eul, Lohmar.

- Reiß, M. (2006). Virtuelle Unternehmen: Vom Mythos zum Modell. Marre nga: http://elib.uni-stuttgart.de/opus/volltexte/2008/3522/pdf/Michael_Reiss.pdf
- Rockart, J.F. (1979): Chief executives define their own data needs, in: HBR, March/April 1979
- Schmalen, C., Kunert, M., & Weindlmaier, H. (2006). Erfolgsfaktorenforschung: Theoretische Grundlagen, methodische Vorgehensweise und Anwendungserfahrungen in Projekten für die Ernährungsindustrie. Unternehmen im Agrarbereich vor neuen Herausforderungen, Münster, 351-362.
- Scholz, C. (1994). Die virtuelle Organisation als Strukturkonzept der Zukunft?. Univ. des Saarlandes.
- Snehota, I., & Hakansson, H. (Eds.). (1995). Developing relationships in business networks. Londres: Routledge. Marre nga: <http://impgroup.org/uploads/books/0-415-11570-1.pdf>
- Sydow, J., & Duschek, S. (2011). *Management interorganisationaler Beziehungen: Netzwerke-Cluster-Allianzen*. Kohlhammer.
- Tjaden, G. (2013). *Erfolgsfaktoren virtueller Unternehmen: eine theoretische und empirische Untersuchung*. Springer-Verlag.

INTERNET BANKING NË SHQIPËRI. PËRSHTATJA ME RREGULLAT EUROPIANE DHE SFIDAT E REALITETIT SHQIPTAR

ERJONA CANAJ PHD

Fakulteti Juridik, Universiteti European i Tiranës

ABSTRAKT

Sistemi bankar dhe veprimet bankare ne ditët e sotme zë një vend shumë të rëndësishëm. Internet banking është një hap më sipër, pasi ky shërbim u lejon klientëve të kenë akses në llogaritë e tyre 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, drejtpërsëdrejti pavarësisht vendndodhjes së tyre, në shtëpi, në udhëtim, zyrë etj. duke zgjedhur veprimet financiare që dëshirojnë të kryejnë. Me fjalë të tjera, internet banking mund ta përkufizojmë si një nga shërbimet në distancë, me anë të së cilës, nëpërmjet aksesit elektronik, klienti mund të kryejë veprimtari financiare. Zhvillimet e shpejta në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit gjatë dekadave të fundit kanë transformuar mënyrën se si operojnë bizneset, dhe kanë rezultuar në ndryshime në modelet e tregtisë globale për mallra dhe shërbime. Lloje të ndryshme aktiviteteve ekonomike dhe transaksione financiare, nga rezervime online e deri shërbimet financiare, shkarkime, arsimim, shërbimet profesionale dhe këshilla mjekësore, përbëhen në një masë të madhe nga të dhënat dixhitale. Përdorimi i teknologjisë së informacionit i bën këto shërbime më të aksesueshme, të menjëhershme dhe të pavarura nga vendndodhja e marrësit apo ofruesit të përmbajtjes.

Qëllimi i këtij studimi është trajtimi i aspekteve kryesore që shoqërojnë shërbimin e-banking duke u ndalur në mënyrë të veçantë tek kontrata a tipike e-banking si dhe siguria ne veprimet bankare on line. Nëpërmjet një analize si historike ashtu edhe kronologjike janë dhënë ne mënyrë të përmbledhur aspektet kryesore të kësaj marrëdhënieje, përshtatja me legjislacionin european, nevoja për rishikime dhe përmirësime, zhvillimin dhe qasjen e saj në praktikën gjyqësore, si dhe disa rekomandime teorike dhe praktike.

Fjalë kyç: *internet banking, legjislacioni european, kuadri ligjor shqiptar, shërbimi e-banking, kontrata on line, siguria bankare etj.*

1. Hyrje

Internet banking është një shërbim u lejon klientëve të kenë akses në llogaritë e tyre 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, drejtpërdrejt pavarësisht vendodhjes së tyre, në shtëpi, në udhëtim, zyrë etj. duke zgjedhur veprimet financiare që dëshirojnë të kryejnë. Me fjalë të tjera, internet banking mund ta përkufizojmë si një nga shërbimet në distancë, me anë të së cilës, nëpërmjet aksesit elektronik, klienti mund të kryejë veprimtari financiare. “E-banking përfshin të gjithë veprimtarinë bankare që realizohet nëpërmjet internetit” vërehet se përkufizimi është gjithëpërfshirës, pasi siç mund të imagjinohet, e ardhmja e këtij shërbimi është pa kufij. Megjithatë e banking përdoret gjerazi në ditët e sotme, në zonën evropiane mungon një përkufizim i posaçëm ligjor apo qoftë edhe rregullimi i kuadrit ligjor përmes një direktive të posaçme. Megjithatë kjo vjen për shkak se Bashkimi Evropian, e rregullon këtë shërbim në kuadër të shërbimeve tregtare përmes direktivave të e-commerce dhe direktivave mbi funksionimin e sistemit bankar. Ligji evropian për aspektet kontraktuale të e-banking është një shkrimje e ligjit të kontratave, të ligjit të marrëdhënies bankier - konsumator dhe, në varësi të aspekteve të veçanta, të ligjit që rregullon kontratat bankare dhe shërbimet. Një larmishmëri e madhe e precedentëve i ka përshtatur më tej këto rregulla dhe parime sipas kërkesave të veçanta të praktikës bankare dhe financiare. Për më tepër, statutet e veçanta, instrumentet e mesme statutore dhe rregulloret administrative mbivendosin kufizime, përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet në fazën para-kontraktuale dhe fazën kontraktuale, kryesisht për qëllime të mbrojtjes së konsumatorit, depozituesit dhe investitorit, transparencës, ruajtjes së sekretit dhe drejtësisë në praktikën bankare ose, më rrallë, për shkak të politikave ekonomike dhe monetare. Shërbimet bankare më të sofistikuar i sigurojnë akses konsumatorëve në llogaritë e tyre, aftësinë për të lëvizur paratë e tyre ndërmjet llogarive të ndryshme, të bëjnë pagesa ose të aplikojnë për kredi nëpërmjet kanaleve elektronike”.

2. Analiza e Gjetjeve

Sistemi bankar në Republikën e Shqipërisë, përkatësisht veprimtaria e bankave tregtare, rregullohet nga ligji nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”¹. Subjekte të këtij ligji janë personat që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare, sipas përcaktimeve në nenet 4 dhe 54². Megjithatë vëmë re se në këtë ligj nuk jepet ndonjë përkufizim i e-banking, po ashtu nuk rregullohet ky shërbim. Tërthorazi, neni 129 flet për sistemet elektronike të pagesave dhe barazinë e tyre me dërgimin e urdhërit me shkrim. Neni 4³ dhe neni 21⁴ janë me rëndësi në këtë drejtim, pasi në mbështetje të këtyre neneve, Banka e Shqipërisë, me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, miratoi rregulloren nr.28, datë 30.03.2005 “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”. Kjo rregullore përbën kuadrin ligjor kryesor të rregullimit të internet banking në Shqipëri. Në referim të nenit 4 të kësaj rregulloreje, gjejmë përkufizimin shqiptar për internet banking: “E-banking është shërbimi në distancë, nëpërmjet kanaleve elektronike të shpërndarjes dhe të komunikimit, i produkteve dhe i shërbimeve tradicionale dhe të reja bankare, brenda veprimtarive të lejuara për bankat e nivelit të dytë”. Nisur nga pesha që zë legjislacioni Evropian në legjislacionin shqiptar por edhe nga aspiratat e shtetit tonë për t’u bërë pjesë e Bashkimit Europian, mendoj se paraqet rëndësi studimi i kuadrit ligjor Evropian për sa i përket e-banking. Influenca e legjislacionit komunitar ndihet ndjeshëm në legjislacionin tonë të brendshëm kjo edhe për shkak të kërkesave të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA). Legjislacioni evropian për aspektet kontraktuale të e-banking është një shkrimje e ligjit të kontratave, të ligjit të marrëdhënies bankier - konsumator dhe, në varësi të aspekteve të veçanta, të ligjit që rregullon kontratat bankare dhe shërbimet. Ky rregullim ligjor gjendet zakonisht në vendet e common law e përkatësisht në Angli por edhe në kodifikimet civile apo tregtare të civil law si p.sh Franca, Gjermania etj. (Ross Cranston, C. Gavalda J. StouZet 2002). Transfertat elektronike të fondeve, të kryera nëpërmjet internetit, janë anëtare të familjes së zgjeruar të aplikacioneve elektronike bankare dhe transferimeve të fondeve elektronike (EFT), të cilat përfshijnë çdo lloj urdhërpagese, kryer nëpërmjet një pajisjeje elektronike, instrumenti telefonik ose kompjuteri ose shiriti magnetik në mënyrë që të urdhërojë, të udhëzojë apo autorizojë një institucion financiar për të kryer veprimtari bankare. Transmetimi elektronik i mandatit të klientit është i pari hap i një procesi shumë të standartizuar të përcaktimit të pozitës reciproke të debisë dhe kredisë të bankës së debitorit dhe përfituesit dhe transferimin e vlerës nga banka e debitorit për bankën e përfituesit në zgjidhjen përfundimtare të borxhit që i detyrohet i pari të fundit. Interneti përdoret si ndërmjetës i transmetimit të mandatit dhe komunikimi i informacionit të rëndësishëm në lidhje me transaksionin, në mënyrë dixhitale, mes bankës e klientit të saj. Nga një perspektivë kontraktuale, banka duhet të kryejë mandatin e klientit me kujdes dhe aftësi të arsyeshme.

Në Bashkimin Evropian ende nuk ekziston një direktivë e veçantë që të përmbledhë kuadrin rregullator për e-banking por pavarësisht kësaj, baza ligjore për rregullimin e këtij shërbimi është e ndarë midis disa direktivave e rregulloreve. Direktiva kryesore, që përbën edhe gurin e themelit për sa i përket të drejtës evropiane në fushën e sistemeve bankare është Direktiva

Ligj nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” ndryshuar me Ligj nr.8893, datë 25.07.2002 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8384, datë 29.07.1998.

Neni 2 i ligjit.

Neni 4 ligjit për Bankën e Shqipërisë thuhet: Banka e Shqipërisë gëzon të drejtën: a) të lidhë kontrata; b) të nxjerrë akte normative; c) të posedojë, të gëzojë, të disponojë, si dhe të blejë pasuri të luajtshme ose të paluajtshme që i shërbejnë veprimtarisë së saj; ç) të tregtojë letra me vlerë, të shpërndajë letra me vlerë për llogari të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe të emetojë letra me vlerë për llogari të vet.

Neni 21 i ligjit thotë: “Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me bankat e tjera, ka të drejtë të caktojë rregulla dhe procedura për kryerjen e pagesave me instrumente që përdoren si mjete pagese, si dhe për shërbimet mbi transfertat elektronike dhe telegrafike”.

e Kodifikuar e Bankave e cila përmbledhi një numër të madh Direktivash të Bashkimit Evropian. Ky kodifikim synonte krijimin e një teksti të vetëm ligjor për të garantuar qartësinë, thjeshtimin, dhe praktikitetin e këtij kuadri ligjor. Direktiva e Kodifikuar Bankare u riformulua në 2006 në të ashtuquajturën Direktiva lidhur me ngritjen dhe ndjekjen e biznesit të institucionit të kreditit 2006/48/EC për shkak të amendimeve të shumta që iu bënë; Direktiva 97/5/EC e 27 janar 1997, mbi transfertat ndërkufitare të kreditit, rregullon transfertat e krediteve për persona fizikë apo bizneset nga një vend i BE në tjetrin, në mënyrë të shpejtë, efikase dhe të sigurtë; Direktiva e E-parave- Direktiva 2000/46/EC e 18 shtator 2000 e cila rregullon, ndjekjen, mbikëqyrjen e kujdesshme të biznesit të institucioneve të parasë elektronike, ka për qëllim nxitjen e tregut të vetëm të shërbimeve financiare me futjen e një numri minimal të rregullave të maturimit, të harmonizuara për lëshimin e parasë elektronike dhe duke aplikuar masat për njohjen reciproke të mbikëqyrjes të parashikuara në Direktivën 2000/12/EC2, të institucioneve të parasë elektronike. Amendamenti prezantuar nga Direktiva 2000/28/EC e 18 shtator 2000 për përkufizimin e institucionit të kredisë në nenin 1, paragrafi 1, nën paragrafi i parë i Direktivës 2000/12/EC e 20 mars 2000 në lidhje me fillimin dhe ndjekjen e biznesit të institucioneve të kreditit detyron institucionet të cilat nuk synojnë të hyjnë në gamën e plotë të operacioneve bankare për të emetuar para elektronike në përputhje me rregullat themelore që rregullojnë të gjitha institucionet e kreditit. Direktiva 2005/60/EC e Parlamentit evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2005 “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmi”; Direktiva e BE-së “Për mbajtjen e të dhënave” (2006/24/EC) parashikon një detyrim për ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike dhe të rrjeteve publike të komunikimit të mbajnë vendndodhjen e të dhënave për gjashtë muaj deri në dy vjet për qëllimin e hetimit, zbulimit, dhe ndjekjen penale të krimeve të rënda. Direktiva 2000/31/EC “Për tregtinë elektronike”. Direktiva 94/19/EC e parlamentit evropian dhe e këshillit e datës 30 maj 1994 “Për skemat e depozitave të garancisë”; Direktiva 2002/65/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 shtator 2002 në lidhje me “Marketingun në distance të shërbimeve financiare të konsumit” e cila amendon Direktivën e Këshillit 90/619/EEC dhe Direktiva 97/7/EC dhe 98/27/EC. Kjo Direktivë duhet të zbatohet në përputhje me Traktatin e BE-se dhe me Direktivën 2000/31/EC “Për tregtinë elektronike”, e dyta e aplikueshme vetëm për transaksionet të cilat ajo mbulon.

Pa dyshim kuadri ligjor ka nevojë të përmbledhet në një direktivë apo rregullore të vetme e cila do të rregullojë gjerësisht shërbimin e e-banking.

Tradicionalisht shërbimet e ofruara nga bankat e nivelit të dytë në Shqipëri, janë depozitat, llogaritë rrjedhëse dhe transfertat bankare. Depozitat kanë qenë produkti më i njohur dhe më i përdorur, por ndërhyrja e qeverisë në politikat ekonomike përmes përpjekjeve për të minimizuar transaksionet në kesh duke detyruar institucionet shtetërore të kryejnë pagesën përmes sistemit bankarë, rrjedhimisht sollën njohjen dhe zhvillimin e shpejtë të shërbimeve të tjera, ndër më të përhapurat përmendim kreditë, over draftet, kartat e kreditit/ debitit etj. Natyrisht duke qenë shërbime tradicionalisht të pa njohura, një pjesë e përdoruesve ishin mosbesues, por gradualisht, me rritjen e sasisë së informacionit dhe avantazhet që ofrojnë këto shërbime, përdorimi i tyre gjeti shtrirje të gjerë. Në këtë proces, mund të themi se bankat kanë rolin kryesor në edukimin e publikut lidhur me shërbimet e reja. Në funksion të këtij qëllimi, janë forcuar kërkesat rregullatore për transparencën e operacioneve bankare me publikun si publikimi i kushteve të punës në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme për të mundësuar krahasimin e tyre midis bankave. Banka e parë që e ka ofruar shërbimin e “internet banking” është Banka Amerikane e Shqipërisë në vitin 2002. Natyrshëm me zhvillimet e reja, bankat e tjera nuk kanë mbetur pas. Banka Raiffeisen, me anë të MultiCash, ofron shërbimin e transfertave. Gjithashtu dhe Banka Popullore dhe Banka Credins, ofrojnë shërbime online. Faktet e mësipërme flasin për një internet banking në fillimet e tij, në Shqipëri. Megjithëse në tregun shqiptar ekzistojnë banka që kanë mbështetjen e grupeve të fuqishme bankare të huaja, ky shërbim ende nuk është i zhvilluar. Arsyeja kryesore është raporti kosto - përfitim. Nëse nuk ka një numër të rëndësishëm klientësh që do të përdorin këtë shërbim, kostot që lidhen me ofrimin e shërbimit, do të sillnin humbje për bankat. Nga ana tjetër, nëse nuk ofrohet një shërbim i caktuar është e vështirë të përcaktohet numri i përdoruesve potencialë të tij, kryesorja mbetet infrastruktura e telekomunikacionit, pasi me zhvillimin e saj, efektet janë pozitive dhe në shërbimin e-banking. Natyrisht në zhvillimin e e-banking, rol të rëndësishëm luan edhe Banka e Shqipërisë përmes miratimit të rregullores që formojnë bazën ligjore për këtë shërbim. Ekzistenca e një baze solide ligjore përgjatë viteve të fundit ka ndikuar dukshëm në përhapjen dhe zhvillimin e e-banking. Nisur nga ecuria e produkteve të kartave dhe kredive, ndoshta edhe internet banking në Shqipëri do të ketë një zhvillim edhe më të shpejtë në të ardhmen. Megjithatë, kjo do të varet në rradhë të parë, nga siguria që do të ofrojnë bankat lidhur me këtë shërbim dhe së dyti, nga transparenca me klientët.

Sipas ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” autoriteti i vetëm përgjegjës për dhënien e licencave dhe mbikëqyrjen e të gjitha bankave në Republikën e Shqipërisë është Banka e Shqipërisë. Në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë janë të përcaktuara kriteret dhe kushtet për të marrë licencë për kryerjen e veprimtarive bankare dhe financiare nga bankat dhe subjektet e tjera financiare jo banka. Në zbatim të strategjive të tyre, bankat vazhdimisht kërkojnë shtim të veprimtarive dhe të produkteve e shërbimeve që ofrojnë. Kërkesat për miratim të veprimtarive shtesë dhe të produkteve të tjera bankare bëhen në mbështetje të dispozitave ligjore dhe të akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë. Referuar neni 6 të rregullores nr.28, datë 30.03.2005 “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”, banka mund të kryejë veprimtari e-banking vetëm pas verifikimit të plotësisht të kushteve nga ana e Bankës së Shqipërisë. Pas kryerjes së veprimeve të nevojshme, banka tregtare njofton Bankën e Shqipërisë për kryerjen e verifikimit.

Direktiva e Kodifikuar e Bankave 2000/12/EC.

“Bankat në epokën e internetit” botim elektronik i Bankës Shqipërisë, www.bankofalbania.org. Aksesuar për herë të fundit në datë 18 prill 2015.

Ndër kushtet që duhet të plotësojnë bankat janë:

këshilli drejtues i bankës duhet të marrë një vendim për kryerjen e veprimtarisë e-banking;

bëhet vlerësimi i efekteve të përdorimit të e-banking në rezultatin e bankës nëpërmjet pasqyrave financiare për tre vitet e ardhshme;

banka tregtare paraqet para Bankës së Shqipërisë listën e transaksioneve bankare që do të kryejnë së bashku me kanalet e komunikimit që do të përdoren, procedurat e funksionimit të e-banking dhe programi i kontrollit të brendshëm për këtë qëllim, të dhënat për kërkesat teknike, marrëveshjen e mbështetjes elektronike etj.

Në vijim të funksionit të saj mbikëqyrës, Banka e Shqipërisë mund të urdhërojë bankën të pezullojë në mënyrë të pjesshme ose të plotë shërbimin e e-banking, nëse gjatë procesit të mbikëqyrjes vërehet se banka nuk ka respektuar kërkesat e rregullores⁷. Një pjesë e mirë e bankave ndërkombëtare ofrojnë shërbime e-banking pavarësisht vendndodhjes, përmes faqeve interaktive online si dhe degëve të licencuara apo filialeve bankare. Aktiviteti bankar ndërkombëtar elektronik është një zgjerim i biznesit bankar në tregjet e huaja. Pra kemi një zgjerim të kanaleve të komunikimit. Natyrshëm lind pyetja, kujt legjislacioni do i nënshtrohet e-banking në rastin kur veprimi bankar kryhet në një vend të ndryshëm nga selia e bankës? Në përgjigje të pyetjes, mund të themi se transaksionet e-banking i nënshtrohen ligjit dhe juridiksionit të atij vendi ku kryhen. Në një ekonomi moderne që karakterizohet nga bashkëpunimi reciprok, lind pyetja nëse një bankë mund të zgjerojë kanalet e komunikimit e si rezultat edhe tregun e saj me një licencë ekzistuese apo është e nevojshme marrja e licencës në vendin e ofrimit të shërbimit? Komiteti i Bazelit pranon se në bazë të rregullave lokale në shumë juridiksione, një bankë e huaj që bie nën kërkesat lokale të licencimit bankar, duhet të krijojë një prani fizike në vend dhe të përdori një seli për të kryer transaksione me banorët lokalë. Megjithatë, sipas rregullave në disa juridiksione, mbikëqyrësit lokal mund të lejojnë një bankë të huaj për të marrë një licencë kur ajo ofron produktet dhe shërbimet e-banking në tregun vendas pa imponuar domosdoshmërisht praninë fizike. Në referim të rregullores “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”, nenit 3: “Subjekt i kësaj rregulloreje janë të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja (më poshtë, bankat), që kryejnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë dhe që synojnë kryerjen e veprimtarisë bankare në rrugë elektronike”. Në interpretim a contrario shohim se subjektet e huaja bankare që kërkojnë të ofrojnë shërbimin e tyre e-banking në tregun shqiptar, pa pasur degë në Republikën e Shqipërisë, nuk mund të kryejnë këtë funksion me licencën ekzistuese të vendit ku kanë selinë bankare. Sipas nenit 3 të ligjit për bankat, banka ka të drejtë të hapë degë, agjenci bankare, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe të ofrojë shërbime ndërkufitare dhe të hapë zyra përfaqësimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë përcakton kushtet dhe kriteret e hapjes së një dege, agjencie bankare, zyre përfaqësimi ose ofrimit të shërbimeve bankare dhe/ose financiare ndërkufitare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Nisur nga neni i mësipërm, veçanërisht fraza “ofrimi i shërbimeve bankare” lihet të kuptojmë se për ofrimin e një shërbimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është Banka e Shqipërisë që vlerëson të drejtën e ofrimit të këtij shërbimi në varësi të përmbushjes së kriterëve. Në vijim, duke iu referuar ligjit për bankat, konkretisht nenit 5, parashikohet: “Veprimtaria bankare në Republikën e Shqipërisë ushtrohet nga: a) banka me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe e licencuar nga Banka e Shqipërisë; b) dega e bankës së huaj e licencuar nga Banka e Shqipërisë” dhe nenit 6 pika 2 “Asnjë subjekt nuk lejohet të ushtrojë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë pa licencë nga Banka e Shqipërisë”, arrijmë në përfundimin se: Pavarësisht se ligji nuk shprehet në mënyrë eksplicite, nga fryma e ligjit dhe interpretimi i dispozitave të veçanta, e-banking është një veprimtari bankare e cila nuk mund të ushtrohet në territorin e Republikës së Shqipërisë pa një licencë nga Banka e Shqipërisë. Mund të kuptojmë se qëllimi i ligjvënësit për të vendosur këtë kusht ka qenë pikërisht mbrojtja e klientit. Në qoftë se një bankë e huaj do të ushtronte veprimtari bankare në Shqipëri me një licencë të huaj, pa praninë e saj fizike, do të mund t’i shmangej edhe kontrollit që ushtron Banka e Shqipërisë.

. Kjo jo vetëm që do të binte në kundërshtim me ligjin për bankat, por edhe dëmton interesat e konsumatorit/klientit dhe ekonomisë në përgjithësi. Pavarësisht se qëllimet e ligjvënësit janë të kuptueshme, me zhvillimin e vullshëm teknologjik, vendosja e pengesave për shtrirjen e e-banking mund të sjellë pasoja negative për ekonominë dhe investimet në vendin tonë. Zhvillimet e fundit në ligjin juridiksional ose marrëveshjet ndërkombëtare mendohet të lejojnë konvergencë më të madhe në licencimin e praktikën në të ardhmen. Në këtë këndvështrim, Bashkimi Evropian në kuadër dhe të programeve të «Pasaportës europiane» të qytetarëve brenda bashkimit, në bazë të njohjes të ndërsjellë, ka avancuar në kuadër të shërbimeve ndërkufitare të e-banking duke parashikuar ofrimin e tyre përmes një procedure të thjeshtuar licencimi. Në thelb, njësia ekonomike e huaj është e autorizuar për të vepruar në juridiksionin e huaj, sepse të dy vendet janë anëtarë të BE-së. Kërkesat e tyre të licencimit konsiderohet të jetë ekuivalente, nga të gjitha vendet e BE-së.

Cili është ligji i aplikueshëm dhe juridiksioni në rast konflikti në kontratat ndërkufitare e-banking?

Kontrata e-banking për vendosjen e marrëdhënies bankë - klient lidhur brenda territorit shqiptar, është një kontratë e cila nuk paraqet problematike për sa i përket juridiksionit. Për këtë kontratë, në rastin e mosmarrëveshjeve zbatohen normat e Kodit të Procedurës Civile mbi juridiksionin e gjykatave». Banka e Shqipërisë parashikon se për ofrimin e shërbimit e-banking, banka e huaj duhet të licencohet sipas ligjit shqiptar. Kjo mund të bëhet duke hapur një degë brenda kufijve territorial të shtetit

Neni 7 pika b rregullores nr.28, datë 30.03.2005 “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”;

Ligji nr.8269, datë 23.12.1997”Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar Neni 3 pika 4/c.

Neni 36-40 i Kodit të Procedurës Civile.

shqiptar, edhe në këtë rast problem i juridiksionit do të zgjidhet sipas ligjit vendas. Problem paraqet rasti kur të dy palët e kontratës e-banking kanë vendbanime të ndryshme. Për shembull: Le të supozojmë se një klient në vendin A ose ndryshe në Shqipëri (vendi i destinacionit të shërbimeve) hap një llogari bankare në një bankë që ofron shërbimin e-banking e cila vepron (ka seli) në një vend B (vendi i origjinës së shërbimeve). Konsumatori mund të përdorë llogarinë dhe shërbimin e internetit për të paguar për mallrat dhe shërbimet në vendin B (ku është hapur llogaria), ose në vendin A (ku jeton konsumatori, Shqipëri) ose në një vend të tretë C. Shihet se, edhe pse banka dhe klienti janë të vendosura në vende të ndryshme, transferimi elektronik i fondeve nga llogaria e konsumatorit në vendin B në llogarinë e një përfituesi në vendin B do të ishte një transferim krediti i brendshëm i cili nuk përbën transfertë ndërkufitare. Nga ana tjetër, një transferim i fondeve në llogarinë e një përfituesi në vendin A do të përbëjë një transferim ndërkombëtar të kredisë nga llogaria bankare në vendin B në llogarinë bankare në shtetin A, edhe pse iniciatori dhe përfituesi do të jenë banorë në vendin A. Për më tepër, një transferim elektronik i fondeve nëpërmjet shërbimit të internetit në llogarinë bankare të një vendi të tretë C do të përbëjë gjithashtu një transferim ndërkombëtar të kreditit. Nëse palët kanë parashikuar me marrëveshje ligjin i cili do të zgjidhë mosmarrëveshjen konflikti i ligjeve nuk ekziston. Problemi qëndron kur palët nuk janë shprehur në lidhje me ligjin e aplikueshëm. Në Bashkimin Evropian parimet ligjore dhe institucionale të njohjes reciproke dhe kontrollit kombëtar të themeluara në fushën e shërbimeve financiare nga masa të tilla si Direktiva e Konsolidimit Bankar, Direktiva për E-commerce dhe Direktiva për Tregjet në Instrumentet Financiare (MiFiD), harmonizojnë aspekte të rëndësishme të ligjit rregullator ekonomik pa ndikuar në konfliktin e ligjeve kombëtare në çështjet kontraktuale. Por, aspekti kontraktual i aktiviteteve bankare elektronike ndërkufitare, për sa i përket ligjit që rregullon juridiksionin, mbetet i pandikuar nga politikat e BE-së në fushën e shërbimeve financiare dhe tregtisë elektronike dhe subjekti i ligjit të përgjithshëm lidhur me konfliktin e ligjeve dhe juridiksionit, kryesisht Konventës së Romës për sa i përket ligjit të aplikueshëm ndaj obligacioneve kontraktuale¹⁰ dhe Rregullores së Brukselit¹¹.

Marrëveshjet kontraktuale midis palëve në juridiksione të ndryshme ngrenë problematikën se cili ligj zbatohet për kontratën dhe cilat gjykata do të jenë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të mundshme. E drejta ndërkombëtare private me anë të një traktati shumëpalësh ose konvente ose, në rastin e Bashkimit Evropian, me anë të një direktive të BE-së apo rregulloreje, ka për qëllim të sigurojë që kontratat ndërkufitare të udhëhiqen nga i njëjti ligj. Unifikimi i konfliktit të ligjeve kombëtare në Evropë në formën e Konventës së Romës, justifikohet nga e mira e të pasurit një kontratë që rregullohet nga të njëjtat rregulla në çdo shtet ratifikues të Konventës, ku ajo mund të kundërshtohet (Giuliano, Lagarde 2014). Parimi themelor i multilateralizmit në konfliktin e ligjeve është barazia e urdhrave kundërthënëse ligjore para gjyqtarit dhe përcaktimin e ligjit në fuqi mbi bazën e faktorëve objektivë dhe abstrakte. Lex fori nuk përjashtohet nga të qenit ligji i duhur i kontratës por, në parim, nuk gëzon trajtim të veçantë nga gjyqtari, i cili është i udhëzuar për të aplikuar ligjin e një sistemi juridik të huaj dhe të mos përfill ligjin vendas nëse detyrohet nga zgjedhja e palëve ose operacioni i faktorëve objektivë të prezantuar nga Konventa. Në rastin hipotetik të mësipërm, për zgjidhjen e konfliktit duke qenë se midis shteteve të përfshira në këtë konflikt nuk ekziston ndonjë marrëveshje dypalëshe (e supozojmë hipotetike), i referohemi ligjit nr.10 428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”. Sipas këtij ligji, kontrata rregullohet nga ligji i zgjedhur nga palët. Me vullnetin e tyre, palët mund të zgjedhin ligjin e zbatueshëm për të gjithë ose për një pjesë të veçantë të kontratës. Nëse palët kanë caktuar juridiksionin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që rrjedhin nga kontrata, prezumohet se kanë zgjedhur ligjin e atij shteti për rregullimin e kontratës¹². Në masën që ligji i zbatueshëm për kontratën nuk është zgjedhur, në pajtim me nenin 45 të këtij ligji, “ligji që rregullon kontratën për furnizimin e shërbimeve rregullohet nga ligji i vendit ku ofruesi i shërbimit ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm¹³”. Duke qenë se kontrata e-banking është mjaft e ngjashme me një kontratë shërbimi ku banka furnizon klientin vazhdimisht me këtë shërbim atëherë zgjidhja është pikërisht neni 45.

3. Konkluzione dhe rekomandime

Zhvillimet e shpejta në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit gjatë dekadave të fundit kanë transformuar mënyrën se si operojnë bizneset, dhe kanë rezultuar në ndryshime në modelet e tregtisë globale për mallra dhe shërbime. Lloje të ndryshme aktivitetesh ekonomike dhe transaksione financiare, nga rezervime online e deri shërbimet financiare, shkarkime, arsimim, shërbimet profesionale dhe këshilla mjekësore, përbëhen në një masë të madhe nga të dhënat dixhitale. Përdorimi i teknologjisë së informacionit i bën këto shërbime më të aksesueshme, të menjëhershme dhe të pavarura nga vendndodhja e marrësit apo ofruesit të përmbytjes. Në këtë peizazh global ekonomik, institucionet financiare dhe tregjet janë përpjekur të rrisin produktivitetin e tyre, të ulin kostot, të rrisin komoditetin e konsumatorëve dhe zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja. Tregjet financiare janë reformuar, tashmë burimet e financimit dhe të mundësive për investime kryhen përmes internetit duke bërë që tregtarët apo zotëruarit të titujve, të mos varen nga distanca, mungesa e kontaktit personal apo kufijve kombëtar. Në epokën e internetit, përdorimi në masë i e-banking është i natyreshëm. E-banking përfaqëson një term mjaft të gjerë i cili në mënyrë të përmbledhur, nënkupton kryerjen e veprimeve financiare në rrugë elektronike. Ky shërbim ofron komoditet,

Convention on the Law Applicable to Contractual Obligations (Rome, 19 June 1980) consolidated version at OJ 1998, No. C27/34, 26 January 1998;

Council Regulation 44/2001 EC of 22 December 2000 on jurisdiction and the recognition and enforcement of judgments in civil and commercial matters, OJ 2000, No. L12/1, 16 January 2001

Neni 45/1 nr.10 428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”.

Neni 46 (b).

kosto të ulët, disponueshmëri dhe efikasitet në pak kohë. Në Shqipëri ekziston kuadri i nevojshëm ligjor për përcaktimin e mënyrës së funksionimit të këtij shërbimi si edhe kushtet e ofrimit të tij por mendojmë se kuadri ligjor ka vend për t'u përmirësuar.

Është kompetencë e kësaj të fundit, duke u përshtatur më thjeshtë me nevojshmërinë dhe llojshmërinë e marrëdhënieve juridiko-civile, të miratojë rregullore e udhëzime të cilat, në bazë të zhvillimeve teknologjike, do të përditësojnë edhe kuadrin legjislativ të këtij shërbimi. Me anë të interpretimeve të ndryshme, arrijmë në përfundimin se kontrata e-banking, është një kontratë konsensuale, formale (për efekt vlefshmërie), e negocueshme dhe e dyanshme. Kontrata e-banking mund të jetë kontratë kryesore apo aksesore. Për të shmangur polemikat apo edhe probleme nga ana praktike, duhet bërë një përcaktim i qartë në ligj për formën e kësaj kontrate, pasi praktikisht formalizimi i saj shihet si një garanci më vete. Si një kontratë e dyanshme, palët në kontratën e-banking ngarkohen me të drejta dhe detyrime reciproke. Disa prej këtyre të drejtave e detyrimeve përcaktohen në ligj, si psh. furnizimi me shërbim të pandërprerë, siguria në rrjet, e drejta e informacionit etj, ndërsa aspekte të tjera janë në vullnetin e palëve. Janë vetë palët që mund të vendosin afatin e kontratës, gamën e shërbimeve që do të përfshijë, personat përdorues etj. Edhe pse nga sa u trajtua në këtë punim, kuptohet se kontrata e-banking është një kontratë e negociueshme, realiteti praktik flet ndryshe. Pas interesimit në bankat kryesore tregtare në Shqipëri, rezulton se kontrata e-banking, është një kontratë standarde dhe fare pak e negociueshme. E thënë ndryshe, bankat i paraqesin klientit një kontratë tip (adezioni) dhe këtij të fundit nuk i mbetet veçse të firmosë. Nga kontratat e-banking të marra nga disa banka, rezulton se kushtet janë pothuajse identike, me luhajtje të vogla në normat e komisionit. Mendojmë se në këtë drejtim duhen marrë disa masa të nevojshme.

Së pari mendojmë se legjislacioni duhet të parashikojë një kuadër negociues të kësaj kontrate, duke parashikuar krahas të drejtave bazë, detajime të mëtejshme, pasi në këtë mënyrë shmang praktikën abuzive ku mbetet vetëm aspekti nënshkrimit në vullnetin e klientit. Në këtë mënyrë jo vetëm që garantohet mbrojtja e nevojshme e klientit si pala e dobët në këtë kontratë, por edhe shmanget konkurrenca e pandershme në treg si edhe promovohet liria e zgjedhjes.

Së dyti ndryshimet duhen bërë jo vetëm në aspektin legjislativ por edhe në aspektin praktik. Kështu, Banka e Shqipërisë duhet të ushtrojë efektivisht autoritetin e saj nëpërmjet kontrolleve të vazhdueshme të kësaj veprimtarie.

Një ndër problematikat e hasura në praktikë, të cilat pjesa më e madhe e bankave e anashkalojnë, është raportimi periodik i klientit rreth gjendjes së llogarisë së tij si dhe të drejtave që gëzojnë. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë si rregullatore dhe mbikëqyrëse e sistemit bankar, duhet t'i sigurojë klientët, kryesisht, për këtë të drejtë ligjore, duke mbikëqyruar zbatueshmërinë e këtij detyrimi nga Bankat Tregtare.

Interes më i madh duhet të tregohet edhe ndaj subjekteve të licencuara të kësaj veprimtarie. Banka është institucion besimi, në këtë kontekst, rregullimi i kuadrit ligjor paraqet rëndësi të veçantë. Nga studimi në treg i kontratës e-banking rezulton se shpesh herë, bankat i shmangen përgjegjësisë pasi bëhen kontraktor ka ndodhur, apo përmes kushteve të komplikuar e të paqarta kontraktore të cilat shpesh herë klientët i nënshkruajnë pa kuptuar detyrimet e marra përsipër apo të drejtat ndaj të cilave heqin dorë. Këto raste paraqesin rrezikshmëri jo vetëm në aspektin e praktikave të padrejta tregtare, por edhe nga vetë ndjeshmëria që karakterizon këtë shërbim. Masat që propozohen në lidhje me vështirësitë e mësipërme kanë të bëjnë edhe me kujdesin ndaj licencimit të subjekteve. Studimi me kujdes i aftësisë së subjekteve kandidatë për të ofruar tek përdoruesi një shërbim e-banking të sigurtë, cilësor, duke siguruar informimin adekuat dhe të drejtuar nga parimi i mirëbesimit reciprok. Natyrisht nëpërmjet kuadrit ligjor Banka e Shqipërisë mund të ndalojë ushtrimin e praktikave të padrejta, të sigurojë mbrojtje të mëtejshme dhe të detajuar të klientit si edhe të vendos sanksione për shkeljet përkatëse, pa anashkaluar asnjë konstatim. Një mënyrë shmangieje është edhe botimi periodik i buletineve të Bankës së Shqipërisë. Nëpërmjet këtyre buletineve, duke i bërë të aksesueshëm për të gjithë publikun, banka mund të rrisë ndjeshëm informacionin e përgjithshëm për shërbimin e-banking si edhe të ndërgjegjësojë klientët për të drejtat e tyre apo rreziqet që mund të hasin duke përdorur këtë shërbim.

Në rastet e praktikës, abuzime nga përdoruesit e llogarive bankare kanë qenë të shumta, çka janë bërë shkas i një serie veprimesh penale ku bashkëpunëtorë kanë qenë vetë drejtuesit e bankës. Duke interpretuar gjerësisht dispozitat në këtë temë është mbajtur qëndrimi se banka nuk është përgjegjëse për shpërbimin e dëmit jashtëkontraktor ndaj përdoruesit. Kjo sepse të gjitha operimet që kryen në llogarinë bankare nëpërmjet shërbimit e-banking, banka i konsideron si të kryera nga klienti. Megjithatë ky pozicion është mjaft i diskutueshëm pasi në këtë mënyrë lihet i pambrojtur përdoruesi. Për këtë arsye mendoj se kuadri ligjor duhet korrigjuar dhe saktësuar në lidhje me statusin e përdoruesit. Nga ana praktike por edhe teorike ka mjaft rëndësi përcaktimi i të drejtave dhe detyrave të përdoruesit si edhe garantimi i mbrojtjes ligjore për këtë subjekt. Në shikim të parë, ofrimi i shërbimeve nëpërmjet internetit nuk duket të jetë një stimulator tipik polemikash, por duke e studiuar nga afër, jemi detyruar të mbajmë një tjetër qëndrim. Interneti zvogëlon distancat, krijon akses në tregje dhe potencialisht mundet t'i japë më shumë zgjedhje për konsumatorët, veçanërisht ata në shtetet më të vogla. Kjo perspektivë e ka vendosur këtë debat në thelbin e politikave dhe interesave që veprojnë në tregjet financiare. Duke qenë se e-banking është mjaft e ndryshme nga modelet e tjera të hyrjes në treg, tensioni mes shërbimeve të internetit dhe koncepteve tradicionale të juridiksionit dhe të kontrollit të tregut mbi aktivitetet ndërkuftare ka qenë veçanërisht i fortë. Në një model të njohjes reciproke të mospërsosmërisë së ligjeve kombëtare dhe kontrollit jo të plotë kombëtar, shërbimet e internetit duhet të kapërcejnë një ose më shumë nga katër problematikat kryesore: pasiguria e ligjit të aplikueshëm, ligje kontradiktore, kosto informacioni, mbi rregullim dhe adaptim i detyrueshëm i shërbimeve dhe produkteve sipas ligjit të çdo tregu kombëtar, të cilat shkatërrojnë mundësitë për hyrjen në treg të njëkohshme nga një lokacion i vetëm dhe kosto minimale hyrjeje dhe operative. Problemet e mësipërme janë karakteristikë jo vetëm e tregut financiar shqiptar por edhe atij evropian. Zhvillimet e shpejta në sferën teknologjike nuk janë shoqëruar me zhvillime po aq të shpejta ligjore. Përkundrazi aspekti ligjor vendos mjaft kufizime në të drejtën për të hyrë në tregun financiar shqiptar si p.sh. çelja e një dege e bankës së huaj. Arsyeya e këtyre kufizimeve është natyrisht mbrojtja e

klientit nga praktikat e padrejta, por mund të themi se kjo mbrojtje mund të realizohet duke unifikuar praktikat ligjore për sa i përket kushteve të licencimit dhe ofrimit të shërbimit e-banking. Kështu, një direktivë e Bashkimit Europian jo vetëm do të unifikonte kuadrin ligjor të e-banking për do të zvogëlonte edhe problemet e paqartësisë në lidhje me këtë shërbim. E-banking është një shërbim mjaft delikat për sa i përket aspektit të sigurisë. Duke qenë se të gjithë veprimet financiare kryhen «online», pra nëpërmjet shërbimeve informatike, rreziku i ndërhyrjeve në rrjet është i madh. Krimi kibernetik apo vjedhja e identitetit përmes teknologjisë së informacionit, janë disa nga problematikat kryesore si edhe anët negative të këtij shërbimi. Për këtë arsye ka qenë e nevojshme përcaktimi i kuadrin ligjor për të mbrojtur interesat e klientit si palë më e «dobët» në këtë marrëdhënie kontraktore. Banka e Shqipërisë ka parashikuar në mënyrë të detajuar mbrojtjen që duhet t'i ofrohet klientit nëpërmjet rregulloreve specifike për shërbimin e-banking por edhe në mënyrë të përgjithshme ndërmjet ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”. Të drejtat e klientit përfshijnë mbrojtjen e të dhënave, të drejtën e informacionit, siguria e transaksioneve në rrjet etj. Ajo që nuk parashikohet nga ligji është masa e përgjegjësisë së bankës si edhe rastet shteruese në të cilat ajo mban përgjegjësi. Duke qenë se legjislati shqiptar hesht për sa i përket këtij aspekti, mendojmë se legjislati shqiptar duhet plotësuar duke parashikuar përgjegjësinë e bankës për shlyerjen e dëmit ndaj klientit nëse ajo nuk ka marrë masat e nevojshme të ndalojë ardhjen e këtij dëmi apo nuk ka marrë masat që normalisht do të priteshin prej saj.

Bibliografia

- Allen Berger, “The Economic Effects of Technological Progress: Evidence from the Banking Industry (2003) 35 Journal of Money, Credit and Banking
- Apostolos ath. Gkoutzinis, “Internet banking and the law in Europe, regulation, financial integration and electronic commerce”, 2006, ISBN-13 978-0-511-34861-7
- Arbi Agalliu 2013 “Kapitali human përballë Sfidave të sistemit bankar në Shqipëri”. Temë Dizertacioni, Tiranë
- Argita Malltezi, Jonida Rustemaj, Lealba Pelinku (2013) Aspekte të së drejtës së biznesit në Shqipëri, MediaPrint.
- Bankat në epokën e internetit botim elektronik i Bankës Shqipërisë, 2010. C. Gavalda and J. StouZet, Droit Bancaire 2002, Paris, Litec
- E drejta e detyrimeve, (2008) Ardian Nuni, Ilir Mustafaj, Asim Vokshi, Tiranë
- European Central Bank : “Recommendations for the security of internet payments” Final version after public consultation, Janar 2013 Historiku i Bankave në Shqipëri”, Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave, Nëntor 2012
- Konferenca e 35-të ndërkombëtare e komisionerëve të mbrojtjes së të dhënave dhe të Privatësisë, Varshavë, Poloni, 23 deri 26 shtator 2013, “Rezoluta mbi monitorimin e faqeve të internetit dhe mbrojtjen e privatësisë”.
- Laudon, Kenneth C.; Guercio Traver, Carol (2014). E-commerce. business. technology. society. 10th edition. Pearson. ISBN 978-013-302444-9
- Mahmood Shah and Steve Clarke, ”E-Banking Management: Issues, Solutions, and strategies” 2009, ISBN 978-1-60566-252-7
- Norbert Horn (ed.), (1999) German Banking Law and Practice in International Perspective, New York Walter de Gruyter,
- Orhan Zarshati 2011 “Historiku i Bankës Kombëtare Tregtare, lindja dhe puna e një banke konkurese” Tiranë, Mediaprint
- Ross Cranston (ed.) (1998) Banking Law – The Banker–Customer Relationship, London: Lloyd’s of London Press. Ross Cranston, Principles of Banking Law, 2002, Oxford University Press.
- Udhëzues për përdorimin e nënshkrimit elektronik”, Autoriteti Kombëtar për çertifikimin elektronik, Nr. 001, Buletini Shtator 2011, Versioni 1.3
- Xavier Freixas dhe Jean Charles Rochet, (2008) “Microeconomy of Banking”
- <http://www.bankofalbania.org/>
- <http://www.oxforddictionaries.com/definition/english/e-banking>
- <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:C:1980:282:0001:0050:EN:PD>
- <http://www.w3.org/People/Berners-Lee/worldwideweb.html>
- <http://www.investopedia.com/articles/general/071213/retail-banking-vs-commercial-banking.asp>
- <http://www.dataprotection.ie/docs/Case-Studies-2012/1354.htm>

RREGULLIMI KONTRAKTOR I MARRËDHËNIEVE PASURORE TË BASHKËSHORTËVE

XHENSILA KADI

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë
xhensila.kadi@fdut.edu.al

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij punimi është analiza e një prej aspekteve që lidhet me marrëdhëniet pasurore në familje, konkretisht me regjimin pasuror martesor. Një nga risitë që ka sjellë kodi aktual i familjes, në lidhje me këtë aspekt, është mundësia e rregullimit me kontratë të këtyre marrëdhënieve. Në këtë kuadër, ligjvënësi shqiptar është mbështetur në modelet e disa prej shteteve anëtare të Bashkimit Europian dhe konkretisht në legjislacionin italian dhe atë francez.

Bazuar në nenet 66 të Kodit të Familjes dhe 659 të Kodit Civil, kontrata martesore është një veprim juridik, nëpërmjet të cilit bashkëshortët e ardhshëm ose bashkëshortët (në situatën kur kontrata martesore lidhet gjatë martesës) përcaktojnë një regjim pasuror të ndryshëm nga ai ligjor. Regjimet pasurore me kontratë që gjejnë rregullim në legjislacionin shqiptar janë regjimi i bashkësisë me kontratë (duke përfshirë këtu edhe regjimin e bashkësisë universale) dhe regjimi i pasurive të ndara. Në gjykimin tonë, rregullimi me kontratë i marrëdhënieve pasurore mes bashkëshortëve, veç avantazheve të tjera, ka si avantazh kryesor përshtatjen e regjimit pasuror me interesat pasurore të secilit bashkëshort dhe me interesat e familjes. Pavarësisht mundësisë që kanë bashkëshortët në rregullimin e përmbajtjes së kontratës martesore, nuk mund të anashkalojmë edhe limitet e parashikuara nga Kodi i Familjes, limite të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e familjes që rrjedh nga martesë. Veç të tjerash, një nga objektivat e këtij punimi është edhe analiza e shkaqeve se përse kontrata martesore ka gjetur përdorim të paktë në praktikë. Pavarësisht se, në kuadër të Bashkimit Europian akoma nuk është arritur të realizohet harmonizimi i së drejtës familjare (konkretisht regjimit pasuror martesor) është hedhur ideja e krijimit të një Regjimi Pasuror Europian opsional.

Fjalë kyç: *martesa, regjimi pasuror martesor, kontratë martesore, avantazhet e kontratës martesore.*

1. Hyrje

Përsa i përket të drejtës familjare mund të themi se, pavarësisht faktit se përbën një degë ose është pjesë e të drejtës civile, në vetvete, ajo është e gjerë dhe e pafundme. Për pasojë, jemi të mendimit se nuk është e vështirë që në këtë fushë të gjejmë tema të reja të cilat mund ti interesojnë lexuesit. Kur flasim për lexuesit nënkuptojmë jo vetëm profesionistët e teorisë dhe të praktikës, por të gjithë lexuesit duke qenë se kushdo është palë në marrëdhëniet familjare, si në marrëdhëniet me karakter personal dhe në ato me karakter pasuror. Në gjykimin tonë, e drejta familjare, më shumë se çdo e drejtë tjetër, përbën një pjesë e përditshmërisë sonë dhe e influencon atë. Ajo është e lidhur ngushtë me zakonet, me kushtet sociale, me etikën dhe kjo bën që ajo të ndryshojë dhe të evoluojë duke ndjekur hapin e kohës.

Nëse i referohemi legjislacionit tonë, mund të themi se kodi aktual i familjes bëri që vëmendja në lidhje me marrëdhëniet familjare të mos fokusohet plotësisht në marrëdhëniet personale midis bashkëshortëve por të drejtohej edhe në ato pasurore. Në gjykimin tonë, marrëdhëniet pasurore midis bashkëshortëve po fitojnë terren dhe janë po aq të rëndësishme sa ato personale, pavarësisht se këto të fundit gjithmonë kanë qenë dominuese.

Konkretisht, titulli III i pjesës së dytë të Kodit të Familjes¹ i kushtohet dhe rregullon marrëdhëniet pasurore në familje. Kjo tregon interesin në rritje të studiuesve të së drejtës dhe hartuesve të kodit mbi marrëdhëniet pasurore. Më shumë se nga ne, interesi në lidhje me këtë pjesë erdhi nga legjislacione të shteteve të tjera dhe nga ndikimi që ato kanë në legjislacionin tonë.

Bashkëshortët kanë mundësinë të parashikojnë me kontratë regjimin pasuror që do tu zbatohet të drejtave e detyrimeve pasurore.² Nga leximi i KF kuptojmë se kontrata martesore përbën një mjet nëpërmjet të cilit mund të rregullohen marrëdhëniet pasurore vetëm ndërmjet bashkëshortëve, pra nuk përfshihen këtu personat që bashkëjetojnë. Bashkëjetesa, pavarësisht se njihet nga legjislacioni ynë³, nuk rregullohet si martesë. Marrëdhëniet pasurore mes bashkëjetuesve mund të rregullohen nëpërmjet një akt-marrëveshjeje e cila duhet të realizohet në formë të shkruar. Ligji parashikon shprehimisht formën e këtij veprimi juridik që nuk është gjë tjetër veçse një marrëveshje para noterit. Pra, për rrjedhojë, mund të themi se përsa i përket regjimit juridik të pasurisë i drejtohem nën 164 KF, duke i paraprirë, në këtë mënyrë, konflikteve që mund të lindin më pas.

2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Në gjykimin tonë, kontrata martesore përbën një aspekt jo pak të rëndësishëm të regjimit pasuror martesor. Me këtë punim, kemi tentuar të shqyrtojmë dhe të interpretojmë një pjesë të vogël të legjislacionit aktual që rregullon kontratën martesore. Pavarësisht se u bënë më shumë se dhjetë vjet që KF ka hyrë në fuqi, vërrejmë se në vendin tonë shumë pak çifte bashkëshortësh zgjedhin të rregullojnë me marrëveshje regjimin pasuror që do të zbatohet gjatë martesës. Synimi i këtij punimi është të ofrojë interpretime në lidhje me:

Rëndësinë e kontratës martesore përsa i përket aspektit pasuror të institutit të martesës;

Elementët që nuk mund të rregullohen nëpërmjet kontratës martesore, pra që nuk mund të jenë pjesë e saj;

Arsyet se përse kjo mundësi, për të zgjedhur një regjim ndryshe nga ai ligjor, gjen një përdorim të pakët në praktikë.

Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Përsa i përket metodologjisë së ndjekur gjatë këtij punimi, mund të themi se analiza e ligjit nënkupton një proces arsyetimi, shpesh herë në një nivel që kërkon përdorimin e një game të gjerë teknikash që synojnë gjetjen e argumenteve ligjorë bindës dhe të pranueshëm. Pikënisja për realizimin e këtij punimi ka qenë identifikimi i problematikave. Ashtu si e përmendëm edhe më sipër, kontrata martesore përbën një alternativë të regjimit ligjor por, që nuk gjen zbatim në praktikë. Nëpërmjet këtij punimi kemi tentuar të gjejmë arsyet e kësaj mungese. Hapi tjetër lidhet me kërkimin doktrinar që konsiston në mbledhjen dhe përpunimin e literaturës. Së fundi, jemi marrë me analizen e normave që rregullojnë këtë element të regjimit pasuror. Duke qenë se normat rregullojnë situata të përgjithshme, metoda e analizës ligjore shërben për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të teorisë dhe të praktikës, nëpërmjet interpretimit të këtyre normave. Jemi përpjekur, gjithashtu, që analizën e ligjit ta gërshetojmë edhe me faktorë të tjerë të jashtëm si studimi i kontekstit social dhe ekonomik.

4. Kontrata martesore, kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e saj

Kontratat martesore, përfaqësojnë veprimin juridik me anë të së cilës dy persona që do të lidhin martesë, krijojnë regjimin pasuror martesor, apo sipas rastit, ndryshojnë ose shuajnë këtë regjim pasuror martesor që ka ekzistuar gjatë martesës.⁴ Përsa i përket regjimit pasuror martesor, mund të themi se kontrata martesore përbën rregullin e përgjithshëm dhe vetëm në mungesë

Në vijim KF.

Omari S., “*E drejtë familjare*”, Botim i dytë, Tiranë, 2008, fq. 109.

Nenet 163 dhe 164 Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003.

Omari S., “*E drejtë familjare*”, Botim i dytë, Tiranë, 2008, fq. 109.

të një marrëveshjeje ndërmjet bashkëshortëve, apo kur kontrata është e pavlefshme do të zbatohet regjimi ligjor. Ekziston dhe mundësia e rregullimit me kontratë vetëm i një pjese të pasurisë. Në një situatë të tillë, regjimi ligjor do të zbatohet mbi pasurinë që nuk rregullohet nga kontrata martesore. Kemi të bëjmë këtu me një regjim pasuror pjesërisht kontraktor dhe pjesërisht ligjor.

Për hartimin e kontratës martesore do ti referohemi regjimit të përgjithshëm për lidhjen e kontratës dhe vlefshmërisë së saj si edhe dispozitave të posaçme të parashikuara nga KF. Duke qenë se KF parashikon disa rregulla të posaçëm në drejtim të kontratës martesore, kujtojmë se në zbatim të parimit *specialia generalibus derogant*, këto rregulla do të zbatohen me përparësi ndaj atyre të kodit civil që rregullojnë kontratën në përgjithësi.⁵

Neni 663 i kodit civil parashikon kushtet e nevojshme për lidhjen e kontratës martesore. Pëlqimi i palëve, nuk përbën gjë tjetër veçse vullnetin e bashkëshortëve për të rregulluar marrëdhëniet pasurore mes tyre me kontratë. Pëlqimi mund të shprehet personalisht nga bashkëshortët ose nga përfaqësuesit e tyre ligjorë. Nga këtu kuptojmë se lidhja e kontratës martesore nuk përbën një veprim ngushtësisht personal. Karakteristikë është fakti se i mituri nuk mund të lidhe kontratë martesore, por do të jetë në regjimin ligjor të detyrueshëm derisa të arrijë moshën madhore. Objekti i kontratës martesore lidhet me krijimin, ndryshimin apo shuarjen e regjimit pasuror. Kemi të bëjmë me krijimin e regjimit pasuror në situatën kur kontrata lidhet para lidhjes së martesës. Në këtë rast, pasojat e kontratës do të fillojnë në momentin që lidhet martesë. Ndryshim të regjimit pasuror kemi kur bashkëshortët nga bashkësia ligjore kalojnë në kontratë martesore ose nga një kontratë e parë, ndryshojnë disa aspekte dhe lidhin një kontratë të dytë. Ndryshimi i objektit mund të realizohet vetëm nëse kanë kaluar të paktën dy vjet nga regjimi i mëparshëm. Kemi të bëjmë me shuarje të regjimit pasuror kur bashkëshortët që janë nën regjimin kontraktor, vendosin që të mos funksionojë më kontrata mes tyre. Përveç sa thamë më lart, kemi dhe objektin material që duhet të jetë i përcaktuar, i përcaktueshëm, i ligjshëm, i mundshëm dhe në qarkullim civil. Shkaku përbën qëllimin e palëve për të cilin marin përsipër lidhjen e kontratës martesore dhe duhet të jetë i ligjshëm.

Përsa i përket formës mund të themi se kontrata martesore duhet të ketë formën e aktit noterial për efekt vlefshmërie dhe provueshmërie.

5. Limitet e lirisë kontraktore të bashkëshortëve

Nga sa thamë më sipër, kontrata martesore, nuk mund të rregullojë marrëdhëniet personale mes bashkëshortëve, por vetëm ato pasurore. Këtë e përforcon edhe fakti se nenet që i referohen kontratës martesore, gjenden në titullin III të KF i cili titullohet “Regjimet pasurore martesore”. Neni 67 KF përcakton se bashkëshortët nuk mund t’i shmangen të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin për ta nga martesë⁶, si dhe përgjegjësisë prindërore dhe rregullave të administrimit ligjor dhe kujdestarisë.

Në anën tjetër, edhe përsa i përket marrëdhënieve pasurore, kontrata martesore has disa limite. Me lidhjen e martesës, lindin disa të drejta dhe detyrime për bashkëshortët. Disa nga këto të drejta dhe detyrime kanë karakter personal dhe disa të tjera kanë karakter pasuror. Ndërsa të drejtat dhe detyrimet me karakter personal nuk mund të përfshihen dhe të rregullohen nga kontrata martesore, ato me karakter pasuror mund të jenë pjesë e saj. Por, ajo që nuk duhet të harrojmë është fakti se këto detyrime nuk mund të shmangen nëpërmjet kontratës martesore. Pra, kontrata martesore shërben për të rregulluar masën dhe mënyrën e ushtrimit të detyrimit, por jo shmangien e tij. Nuk duhet të harrojmë se një nga karakteristikat e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga martesë është se ato janë të pashmangshme dhe për rrjedhojë, çdo marrëveshje që shmang ato është absolutisht e pavlefshme. Mendojmë se një përcaktim i tillë nuk është i nevojshëm të parashikohet shprehimisht në një nen të caktuar të kodit. Rëndësia e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga martesë del qartë në pah nga leximi i neneve të kodit. Në anën tjetër mund të bëjmë dhe një paralelizem me martesën midis personave të së njëjtës gjinie. Nuk gjejmë asnjë nen në kod që të përcaktojë pavlefshmërinë e kësaj martesë. Pavarësisht kësaj, jemi të gjithë dakort se një martesë e tillë është absolutisht e pavlefshme. Një martesë e tillë nuk përmbush një nga kushtet thelbësore të lidhjes së martesës, konkretisht ndryshimin e gjinisë midis bashkëshortëve. Madje për një pjesë të doktrinës⁷, kjo martesë konsiderohet inekzistente. Jo rrallë herë ndodh që ligjvënësi të rregullojë shprehimisht ato situata apo parime që konsiderohen të diskutueshme për të evituar në këtë mënyrë keqinterpretimet apo abuzimet.

Duke ju rikthyer diskutimit të mësipërm, mendojmë se ligjvënësi ynë, në këtë aspekt, është treguar tradicional përsa i përket marrëdhënieve personale dhe pamundësisë që ato të rregullohen në kontratën martesore. Një pengesë e tillë, nuk parashikohet shprehimisht në kod, ndoshta për vetë faktin se ligjvënësi e konsideron si të pakonceptueshme mundësinë e bashkëshortëve për të rregulluar me kontratë marrëdhëniet personale mes tyre. E kundërta ndodh me marrëdhëniet pasurore për të cilat mund të lidhet një kontratë martesore, kuptohet në respekt të limiteve që parashikon legjislacioni dhe gjithmonë duke konsideruar primar interesin e familjes.

Kuptohet që bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje në lidhje me ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve që lindin me lidhjen e martesës. Mund të përmendim këtu marrëveshjen në lidhje me vendbanimin e tyre apo me mbiemrin që do të mbajnë gjatë martesës. Por, këto marrëveshje nuk mund të jenë pjesë e kontratës martesore.

Idem.

Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga martesë rregullohen në titullin II të KF. Mund të përmendim: detyrimi për besnikëri, ndihmë (morale dhe materiale), dhe bashkëpunim në interes të familjes, e drejta e mbiemrit, detyrimi ndaj fëmijëve, detyrimi për jetesë të përbashkët, detyrimi për vendbanim të përbashkët, etj.

Omari S., “E drejtë familjare”, Botim i dytë, Tiranë, 2008, fq. 211.

Jemi të gjithë të vetëdijshëm që me kalimin e kohës shoqëria evolon dhe bashkë me të ndryshon dhe evolon edhe e drejta. Në të kaluarën nuk parashikohej zgjidhja e martesës, aktualisht jemi në dijeni të faktit se është rritur shume numri i personave që gëzojnë statusin i/e shkukurëzuar. Për rrjedhojë, nuk mund të përjashtojmë mundësinë që në të ardhmen edhe të drejtat dhe detyrimet me karakter personal të jenë pjesë e kontratës martesore.

Edhe marrëdhënia prind fëmijë nuk mund të jetë pjesë e kontratës martesore duke u bazuar në parimin kushtetues të interesit më të lartë të të miturit.

Pra, bashkëshortët nuk mund të shmangin të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga martesë, por ata mund të zgjedhin rregjimin e pasurive të ndara, të lidhin kontratë martesore, ta modifikojnë atë (kuptohet mbasi të kenë kaluar të paktën dy vjet nga regjimi i mëparshëm). Nëpërmjet kontratës martesore, bashkëshortët vendosin se kujt do ti perkasin sendet e fituara gjatë martesës si edhe mënyrën e administrimit të tyre.

6. Praktika e kontratës martesore në Shqipëri

Kontrata martesore shërben për përcaktimin e regjimit pasuror që do të zbatohet gjatë martesës. Ajo hartohet dhe nënshkruhet nga bashkëshortët, të cilët, zgjedhin në mënyrë të pavarur dhe me marrëveshje se si do të rregullohen marrëdhëniet pasurore mes tyre.

Pyetja që na lind natyrshëm është, mos ndoshta kërkesa e njërit prej partnerëve për hartimin e një kontrate martesore nënkupton mungesën e besimit që ky partner apo bashkëshort ka ndaj tjetrit? Këtu nënkuptojmë rastet kur njëri prej partnerëve realizon më shumë të ardhura se tjetri dhe egziston mundësia që marrëdhënia mes tyre të ngrihet mbi bazën e përfitimeve ekonomike.

Instituti i martesës është shumë i rëndësishëm dhe trajtohet si i tillë nga legjislacioni ynë. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit.⁸ Personat të cilët vendosin të lidhin martesë bazohen kryesisht në afekcionin dhe ndjenjën e ndërsjelltë. Kjo përbën rregullin e përgjithshëm. Kuptohet që ka edhe përjashtime, mund të ndodhë që personat të lidhin martesë për të siguruar përfitime, si mund të jenë përfitimet ekonomike. Pavarësisht kësaj, mendojmë se kontrata martesore nuk mund të shihet si një mosbesim midis partnerëve. Ligji garanton barazinë morale dhe juridike mes bashkëshortëve, por kjo nuk mund të përfshijë edhe barazinë ekonomike. Të gjithë ne jemi të barabartë në të drejta dhe detyrime pavarësisht pasurisë që gëzojmë.

Një tjetër “pengesë” që has kontrata martesore është dhe opinioni publik. Pavarësisht rregullimit ligjor dhe “pranimi” nga kodi i kontratës martesore si një alternativë për rregullimin e regjimit pasuror, në publik kontrata shihet me sy kritik. Pjesa më e madhe e popullsisë nuk e koncepton faktin që bashkëshortët të kenë pasuri të ndara, mundësi kjo që ofrohet vetëm nga kontrata martesore.

Gjithashtu, nuk mund të anashkalojmë faktin se një pjesë e mirë e popullsisë nuk kanë dijeni për ekzistencën e kësaj mundësie që ofron kodi ynë i familjes. Jo të gjithë janë juristë, apo jo të gjithë e konsiderojnë mundësinë për tu drejtuar te një zyrë avokatie për tu informuar mbi pasojat që sjell lidhja e martesës mbi marrëdhëniet pasurore. Në gjykimin tonë, informimi nëpërmjet mjeteve të ndryshme komunikimit si televizioni, radioja, gazetata apo edhe interneti do të ndikonin në vlerësimin dhe pranimin e kësaj alternative.

Megjithatë, pavarësisht se bashkëshortët mund të kenë lidhur një kontratë martesore, ajo nuk mund të zbatohet në rast se nuk plotësohen kushtet thelbësore për vlefshmërinë e saj. Kontrata e lidhur në kushtet e kanosjes apo kontrata e lidhur dukshëm në favor të njërit prej bashkëshortëve duke dëmtuar ndjeshëm interesat e tjetrit do të konsiderohet e pavlefshme.

7. Regjimi pasuror europian

Të gjitha sistemet ligjore europiane, bazojnë regjimet pasurore, ligjore dhe kontraktore, mbi parimin e barazisë së burrit dhe gruas gjatë martesës.⁹ Përgjatë dekadës së fundit është vënë re një interes në rritje i Bashkimit Europian në fushën e të drejtës familjare ndërkombëtare. Në gjykimin tonë, kjo nuk përbën asgjë befasuese, pasi lëvizja e qytetarë, si rezultat i lëvizjes së lirë, është në rritje duke ndikuar në këtë mënyrë në lidhjen dhe zgjidhjen e martesave ndërkombëtare. Duke ju referuar temës në trajtim, pyetja që lind është se çdo të ndodhë më regjimin pasuror që zbatohet mes bashkëshortëve kur ata ndrojnë rezidence, duke u larguar nga njëri shtet në një shtet tjetër? A do të njihet, në rezidencën e re, regjimi pasuror që kanë zgjedhur ata? Kjo është arsyeja se përse ngrihen gjithmonë dhe më shumë pyetje mbi të drejtën ndërkombëtare private. Regjimet pasurore martesore janë të ngjashëm ndërmjet tyre në shumë legjislacione europiane, por ajo që dallon njërin sistem ligjor nga tjetri është roli që ligjvënësi i ka dhënë këtyre regjimeve pasurore.¹⁰ Kështu për shembull, regjimi i pasurive të ndara në disa sisteme ligjore, parashikohet si regjim ligjor, ndërsa në disa sisteme të tjera e gjejmë të rregulluar në formën e regjimit pasuror kontraktor.¹¹

Neni 53, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998.

Qarri E., “Kontrata Martesore”, Disertacion për mbrojtjen e gradës doktor, Tiranë 2014, fq 79.

Idem.

Idem.

Në vitin 2013, mbas më shumë se gjashtë vitesh pune intensive, Komisioni i të Drejtës Familjare Europiane (CEFL)¹² përfundoi hartimin e parimeve në lidhje me marrëdhëniet pasurore mes bashkëshortëve. Fusha e të drejtës e cila ka qenë e hulumtuar nga një perspektivë, përgjithësisht, përcaktohet si e drejta pasurore martesore. Ajo përbën një pjesë/fushë të komplikuar të së drejtës, duke qenë se rregullohet në mënyrë të ndryshme nga juridiksionet europiane ku është bazuar CEFL për të realizuar një studim krahasues. Për më tepër, Komisioni, duke qenë se nuk ishte nën presionin e limiteve kohore, mori gjithë kohën që i nevojitej për të marrë në konsideratë, për të vlerësuar dhe për të shpjeguar me hollësi çdo detaj. Për draftimin e Parimeve u hartua një raport nga ekspertët e Komisionit, rezultat ky i shtatëmbëdhjetë mbledhjeve të Komitetit Organizativ.

Objektivi kryesor i Komisionit në draftimin e parimeve që lidhen me marrëdhëniet pasurore mes bashkëshortëve është që ato të mund të përdoren në procesin e harmonizimit të së Drejtës Familjare Europiane. Harmonizimi i regjimit pasuror martesor në Europë (Bashkimin Europian) është një proces mjaft i vështirë.¹³ Në hapësirën e BE-së ekzistojnë dallime të dukshme ndërmjet regjimeve pasurore martesore, jo vetëm ndërmjet sistemit ligjor common law dhe atij kontinental, por edhe vetë brenda sistemit kontinental; dallime të cilat e kanë burimin e tyre tek historia, kultura, traditat dhe kushtet social-ekonomike të shteteve të ndryshme europiane.

Në gjykimin tonë, harmonizimi do të japë më shumë siguri në çështjet ndërkufitare dhe do të ndikojë në zhvillimin e një zone që mund ta quajmë “Ligj dhe Drejtësi Europiane”.

Konkluzione

Kontrata martesore përbën një mjet nëpërmjet të cilit mund të rregullohen marrëdhëniet pasurore vetëm ndërmjet bashkëshortëve.

Në gjykimin tonë, marrëdhëniet pasurore midis bashkëshortëve janë po aq të rëndësishme sa ato personale, pavarësisht se këto të fundit vazhdojnë të jenë dominuese.

Bashkëshortët, nëpërmjet kontratës nuk mund të rregullojnë marrëdhëniet personale mes tyre.

Në gjykimin tonë, kontrata martesore nuk mund të shihet si një mosbesim midis partnerëve. Barazia morale dhe juridike mes bashkëshortëve nuk mund të përkthehet në barazi ekonomike.

Një tjetër “pengesë” që has kontrata martesore është dhe opinionin publik, i cili e sheh me sy kritik kontratën. Pjesa më e madhe e popullsisë nuk e koncepton faktin që bashkëshortët të kenë pasuri të ndara.

Një pjesë e mirë e popullsisë nuk ka dijeni për rregullimin që i bën kodi kontratës martesore. Jo të gjithë janë juristë, apo jo të gjithë e konsiderojnë mundësinë për tu drejtuar te një zyrë avokatie për tu informuar mbi pasojat që sjell lidhja e martesës mbi marrëdhëniet pasurore. Në gjykimin tonë, informimi nëpërmjet mjeteve të ndryshme komunikimit si televizioni, radioja, gazetat apo edhe interneti do të ndikojnë në vlerësimin dhe pranimin e kësaj alternative.

Së fundi, përsa i përket harmonizimit të regjimit pasuror në europë, pavarësisht rëndësisë, gjykojmë se do të jetë një proces i gjatë dhe i vështirë.

Bibliografi

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998.
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994.
- Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003.
- Gabrieli E., “*I contratti in generale*”, Torino: UTET, 2006.
- Galgano F., “*Il contratto*”. Seconda edizione. Milano: Cedam, 2011.
- Omari S., “*E drejtë familjare*”. Botim i dytë. Tiranë, 2008.
- Qarri E., “*Kontrata Martesore*”, Disertacion për mbrojtjen e gradës doktor, Tiranë 2014.

Commission on European Family Law, në vijim Komisioni.

Qarri E., “*Kontrata Martesore*”, Disertacion për mbrojtjen e gradës doktor, Tiranë 2014, Fq. 85.

RRUGA E SHQIPËRISË DREJT TREGUT TË PËRBASHKËT EVROPIAN. LËVIZJA E LIRË E SHËRBIMEVE.

SOKOL BANA PHD

Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

ABSTRAKT

Vendi ynë, tashmë pjesë e pandërprerë e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Europian, ka ndërmarrë një sërë reformash të realizuara në vijë të njëtrajtshme në përfaqsimin dhe harmonizimin e legjislativës tonë me *acquis communautaire* dhe kuadrin ligjor dhe institucional të BE-së. Sipas kësaj marrëveshjeje mes vendit tonë dhe BE-së parashikohet vendosja e një zone tregtie të lirë ku palët angazhohen të eliminojnë detyrimet doganore, kufizimet sasiore, dhe masat me efekt të njëjtë si dhe vendosjen e barrierave të reja tregtare.

Që të arrihet realizimi i plotë i tregut të lirë mes vendit tonë dhe BE-së, duhen respektuar, ndër të tjera katër liritë themelore të BE-së, si liria e qarkullimit të lirë të personave, mallrave, kapitaleve dhe shërbimeve, ku kjo e fundit është edhe fokusi i trajtimit në këtë punim. Në lidhje me qarkullimin e lirë të shërbimeve marrëveshja e ka trajtuar në nenin (neni 57) të saj, ku palët angazhohen të marrin masat e nevojshme për të lejuar progresivisht ofrimin e shërbimeve nga shoqëritë ose shtetasit e vendeve anëtare të BE-së ose të shtetit të asociuar, rasti konkret vendi ynë, të vendosur në një territor të ndryshëm nga marrësi i shërbimit.

Tashmë Shqipëria është në fazën në të cilën detyrimet e shtetit tonë kanë nevojë për një angazhim më të madh, sidomos pas marrjes së statusit si vendit kandidat. Qëllimi dhe perspektiva për të qenë pjesë e Tregut të Brendshëm të BE-së në përgjithësi dhe pjesë e liberalizimit të shërbimeve dhe vendosjes në veçanti (që janë baza thelbësore e punësimit dhe zhvillimit ekonomik për të gjitha shtetet), janë prioritete të vendit tonë.

Punimi do të fokusohet pikërisht në përfaqsimin e dispozitave për shërbimet dhe vendosjen si dhe hapat e ndërmarrë nga shteti ynë në periudhën e pas ratifikimit të MSA duke evidentuar dhe analizuar problemet dhe sfidat që ka hasur vendi ynë në liberalizimin e lirisë së shërbimeve.

Fjalë kyç: *Ofrimi i shërbimeve, liria e vendosjes, tregu i brendshëm, liberalizimi, MSA, BE.*

1. Hyrje

Shqipëria është pjesë e procesit të Stabilizim-Asociimit së bashku me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe që nga qershori i vitit 2014 është vend kandidat për në BE. Në këtë punim do të trajtohet me hollësi progresi i arritur dhe problemet, në kuadër të procesit të stabilizim asociimit në lidhje me ecuritë dhe reformat e realizuara në përfaqshjen e harmonizimit dhe legjislacionit vendas me *acquis communautaire* për lëvizjen e lirë të shërbimeve, përderisa bëhet fjalë për një proces evolutiv e dinamik njësoj si dhe me vendet e tjera të PSA. Theksi i analizës është përfaqshja e dispozitave për shërbimet dhe vendosjen si dhe hapat e ndërmarrë nga shteti ynë në periudhën e pas ratifikimit të MSA-së, e cila është një ndër 4 shtyllat kryesore¹. Përveç kësaj Shqipëria është në fazën në të cilën detyrimet e shtetit të angazhuar në rrugën e integritimit në BE kanë nevojë për impuls të ri, lidhur kjo edhe me kërkesën që vendi ynë ka bërë për statusin e vendit kandidat për anëtarësim, dhe perspektivës për të qenë pjesë e Tregut të Brendshëm të shërbimeve që janë baza thelbësore e punësimit dhe zhvillimit ekonomik për të gjitha shtetet. Shërbimet konsiderohen si “shërbime?” sipas kuptimit të Traktateve kur normalisht ofrohen kundrejt një shpërblimi, për aq sa nuk rregullohen nga dispozitat, që lidhen me lirinë e lëvizjes së mallrave, të kapitalit dhe personave. Në veçanti, “shërbimet” përfshijnë: aktivitetet me karakter industrial, aktivitetet me karakter tregtar; aktivitetet e artizanëve dhe aktivitetet e profesioneve të lira. GJED-ja, në jurisprudencën e saj të zhvilluar në lidhje me lirinë e qarkullimit të shërbimeve në Tregun Unik, ka përcaktuar një sërë aktivitetesh që cilësohen si shërbime brenda kuptimit të nenit 56 e 57 të TFBE. Ne do të kufizohemi në këtë punim vetëm në përmendjen e tyre duke qenë se nuk janë shërbimet në vetvete fokusi i studimit: praktikimi i sportit/ shërbimet financiare dhe **të sigurimeve**/shërbimet postare, të shoqërisë së informacionit, audiovizuale, transmetimit të sinjaleve e reklamave televizive dhe kinemaja/ofrimi i fuqisë punëtore me qira ose shpërblim/shitja e **udhëtimit nga agjentët e udhëtimit/profesionet mjekësore/profesionet e lira dhe shërbimet juridike të avokatëve/zhvendosja e punëtorëve dhe tregu i punësimit/lojërat e fatit/transportet detare/sistemi fiskal/konçesioni i shërbimeve.**

2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Ky studim ka për qëllim të evidentojë ecurinë dhe progresin e bërë nga Shqipëria në fushën e lëvizjes së lirë të shërbimeve, si një nga katër liritë themelore të Tregut Unik Evropian si dhe një nga shtyllat kryesore të Marrëveshtjes së Stabilizim Asociimit³. Nga ana tjetër do të evidentohen gjithashtu edhe problematikat madhore që janë hasur në këto fusha me qëllim final kapërcimin e tyre dhe ecjen përpara në kauder të anëtarësimit në BE. Kuadri i përgjithshëm i MSA-së përbëhet nga katër shtylla: 1. dialogu politik dhe bashkëpunimi rajonal. 2. dispozitat tregtare lidhur me liberalizimin progresiv të këmbimeve deri në vendosjen e një zone tregtie të lirë mes palëve. 3. liritë komunitare. 4. bashkëpunimi në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme⁴. Me ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Shqipëria ka marrë mbi vete një sërë detyrimesh që duhet të realizohen brenda afatit përfundimtar 31 mars 2019. Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje shumë të rëndësishme për të ardhmen e Shqipërisë është miratuar Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2012–2015, i cili është dokumenti bazë për të gjitha institucionet publike shqiptare për përcaktimin e prioriteteve, planifikimin, koordinimin dhe monitorimin e aktiviteteve për zbatimin e MSA-së. Sipas Marrëveshjes Shqipëria duhet të punojë për plotësimin e 3 kriterëve thelbësorë të anëtarësimit në BE, që janë: kriteri politik -Demokracia dhe shteti i së drejtës, duke përfshirë respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e pakicave kombëtare; kriteri ekonomik- krijimi i një ekonomie tregu funksionale, të aftë për të përballuar trysinë e konkurrencës nga shtetet e tjera anëtare të BE-së; kriteri i *acquis*-së-Përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis*, ngritja e strukturave administrative dhe adaptimi i procedurave administrative për të garantuar zbatimin e plotë, të saktë dhe uniform të këtij legjislacioni. Bazuar në përparimin e Shqipërisë drejt BE-PKZMSA 2012–2015 ka si pikësynim final priorizimin, planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e përafrimit të plotë të legjislacionit shqiptar me *acquis* e si një kusht thelbësor për anëtarësimin e Shqipërisë në BE⁵.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit për Shqipërinë e cila gjendet on line edhe në <http://www.mie.gov.al/>, dhe tek http://ec.europa.eu/enlargement/countries/detailed-country-information/albania/index_en.htm

Neni 57 TFBE.

Me procedura të përshpejtuara hyri në fuqi me 1 dhjetor 2006, Marrëveshja e Përkohshme, e cila parashikon krijimin e një zone të tregtisë së lirë mes dy vendeve, për një periudhë kalimtare 10 vjeçare. Gjithashtu, ajo parashikon fazat e hapjes së tregut vendas për eksportet e BE-së. Të dyja palët angazhohen për të hequr tarifën doganore për mallrat me prejardhje nga vendet e palëve apo masa të tjera me efekt të njëjtë ose të reduktojnë në mënyrë të shkallëzuar tarifën doganore deri në zhdukjen e plotë të tyre gjatë një periudhe tranzitore pesë vjeçare të parashikuar në marrëveshje. Shih: <http://www.mie.gov.al/>.

Marrëveshja përbëhet nga 135 nene, 5 anekse dhe 6 protokolle. Për më tepër shih: <http://www.mie.gov.al/>, dhe http://ec.europa.eu/enlargement/countries/detailed-country-information/albania/index_en.htm.

MSA përveç kuadrit ligjor vendosi detyrimet e ngritjes së strukturave të përbashkëta BE–Shqipëri që janë: -*Këshilli i Stabilizim Asociimit* i cili mbikëqyr zbatimin dhe realizimin e Marrëveshjes dhe shqyrton çdo çështje madhore që del në kuadër të saj dhe ato çështje dypalëshe ose ndërkombe të interes të përbashkët. -*Komiteti i Stabilizim Asociimit*, i përbërë nga përfaqësues të Këshillit të BE-së dhe përfaqësues të Komisionit Evropian, dhe përfaqësues të Qeverisë së Shqipërisë, i cili në përgjithësi garanton vazhdimësi të marrëdhënies së asociimit dhe funksionimin e duhur të MSA-së dhe detyrat e tij vendosen nga Këshilli i Stabilizim Asociimit. -*Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit*. që përbëhet nga anëtarë të Parlamentit Evropian dhe anëtarë të Kuvendit shqiptar dhe mbledhet në intervale kohore që vendosen nga ai vetë për të diskutuar dhe shkëmbyer mendimet e tyre. Canaj E, Bana S. (2014). E Drejta e Bashkimit Evropian. Tiranë: Onufri fq. 245-270.

Përpara se të trajtojmë progresin dhe ndryshimet që kanë ndodhur në legjislacionin shqiptar por, dhe pikat e dobëta mbi të cilat kërkohet ende të punohet fort, duhet të evidentojmë konceptin e shërbimeve dhe të subjekteve të saj. Nga përmbajtja e nenit 56 i TFBE, është identifikuar si një aktivitet (veprimtari) me natyrë vetëpunësimi, që ofrohet normalisht përkundrejt shpërblimit, nga një ofruer (i shërbimit) i vendosur në një shtet anëtar të ndryshëm, nga ai në të cilin do të kryhet shërbimi. Së pari, nga ky përkufizim shihet që: shërbimi si aktivitet ekonomik ka zbatim “rezidual”, hyn në fushën e zbatimit të dispozitave mbi shërbimet, dhe nuk hyn në fushën e zbatimit të klauzolave të traktatit në lidhje me lëvizjen e lirë të mallrave, të personave, të kapitaleve apo të lirisë së vendosjes⁶; shërbimi duhet të jetë në parim i ofruar kundrejt shpërblimit, dhe GJED ka bërë disa saktësime në lidhje me shpërblimin duke e identifikuar atë me shumën e shërbimit të rënë dakord ndërmjet ofruesit të shërbimit dhe të marrësit të tij⁷; ka karakter ndërkuftar⁸; ka karakter të pavarur, pasi u tha më sipër që natyra shërbimit është vetëpunësim dhe karakter të përkohshëm në lidhje me afatin e qarkullimit të tij⁹.

3. Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Ne kete studim do analizojmë veçoritë e shërbimit për të nxjerrë në pah problemet e vështirësitë, apo pengesat në zbatimin e klauzolave në lidhje me lirinë e qarkullimit të tij në TUE. Pyetja kërkimore që shtrohet ne kete drjetim eshte cilat janë këto pengesa lidhur me ecurinë korrekte dhe te duhur lidhur me lëvizjen e lire te shërbimeve ne vendin tone. Gjithashtu nje pyetje e cila vlen ne diskutohet ne kete punim eshte cilat janë realisht shërbimet që ofrohen nga vendi yne me qellim përmirësimin dhe shtimin e tyre ne te ardhmen.

Në fakt në periudhën pas ratifikimit të marrëveshjes dhe deri tani sipas raportit të fundit të Komisionit, performanca e shtetit shqiptar për të realizuar përfaqshjen me *acquis* të legjislacionit shqiptar përsa i përket objektivit të këtij studimi, lëvizjes së lirë të shërbimeve, ka pasur në disa sektorë sukses dhe ne disa te tjera mungesë progresi nga viti 2009 deri në vitin 2014.

Analizën tonë do e mbështesim në këto vite sepse ka më shumë elemente ecurie të zbatimit të MSA-së, dhe po ti referohemi raportit të 2009 konstatohet një avancim i ngadaltë i progresit përveç disa arritjeve në të drejtën e shoqërive dhe në përgjithësi mund të përmbledhim në disa pika, pasi janë përgatitur statute tip për shoqëritë tregtare¹⁰, dhe një manual me qëllim që të lehtësohet zbatimi i ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare (prill 2008). Në bashkëpunim me dhomat e tregtisë dhe industrisë, janë organizuar trajnime për gjyqtarët dhe komunitetin e biznesit në lidhje me zbatimin e këtij ligji. Shënohet progres i mirë në të drejtën e vendosjes, ku vazhdon reforma e regjistrimit dhe liçencimit të shoqërive tregtare dhe miratohet legjislacioni i ri dhe ngritja e Qendrës Kombëtare të Liçencimit, duke reduktuar barrierat administrative dhe duke e bërë krijimin e shoqërive më të shpejtë, më të thjeshtë dhe më të lirë. Një arritje tjetër e evidentuar në Progres raportin e vitit 2009 është miratimi i ligjit të ri për Ekspertët Kontabël dhe Audituesit në mars 2009, ligj i cili përcakton shoqëritë që duhet të auditojnë pasqyrat e tyre vjetore dhe kërkon që profesioni i ekspertit kontabël të jetë subjekt i një sistemi mbikëqyrës publik, dhe përmban dispozita për certifikimin/miratimin e ekspertëve kontabël dhe regjistrimin e tyre dhe të kontabilistëve.

Nga interpretimi i nenit 57, kuptohet që shërbimi për tu konsideruar si i tillë dhe për të hyrë në fushën e zbatimit të nenit 56 e vijues të TFB, duhet të dallohet nga karakteristikat e tij përbërëse që nuk janë të ngjashme me lirinë e lëvizjes së punëtorëve, kapitaleve, mallrave apo lirinë e vendosjes. Siç është vënë re shpesh, Traktati i jep nocionit të shërbimeve një karakter rezidual, [vazhdimësie] duke konsideruar si të tillë, ato ofrime apo prestime të cilat nuk rregullohen nga dispozitat në lidhje me lëvizjen e lirë të mallrave, kapitaleve, e personave. Ndonëse të rregulluara nga TKE në dispozita të veçanta, lëvizjet e kapitaleve janë logjikisht të fushës së shërbimeve, siç janë aktivitetet me karakter industrial, tregtar, aktivitetet artizanale dhe aktivitetet e profesioneve të lira. Toth. A.G., Dr.jur., Ph.D, The Oxford Encyclopaedia of European Community Law, volume II The law of the Internal market, Oxford University Press, 2005, fq.312.

Shërbimet e ofruara për bamirësi, ose pa ndonjë dëshirë për pagesën, nuk mbulojnë nga neni 56. Neni 57 parashikon që shërbimet duhet të jenë të siguruara normalisht për shpërblim. Shpërblimi duhet të jetë në para, për aq kohë sa ai mund të vlerësohet në të holla. Në lidhje me shpërblimin, meqenëse përkufizimi i tij nuk del direkt nga neni 57. Tesauro.G., Diritto dell'Unione European, Sesta edizione, Cedam, casa editrice dott.Antonio Milani, 2010, fq. fq.582; Canaj E, Bana S. (2014). E Drejta e Bashkimit Evropian. Tiranë: Onufri fq. 237-240.

Një kusht për zbatimin e shërbimit sipas nenit 56 të TFBE është natyra ndërkuftare e tij, apo elementi ndërkuftar, që domethënë se ofruesi i shërbimit duhet të ndodhet në një shtet anëtar të ndryshëm nga ai i personit që merr apo përfiton shërbimin. Pa ekzistencën e kufijve të ndryshëm shtetëror në kuptimin e shteteve anëtare të BE-së, shërbimi nuk mund të hyjë në sferën e zbatimit të nenit 56 të TFBE. Canaj E, Bana S. (2014). E Drejta e Bashkimit Evropian. Tiranë: Onufri fq. 237-240.

Që të kemi ofrim shërbimi sipas përcaktimit të bërë në nenet 56 e vijues të TFBE duhet që ai të ketë natyrë vetëpunësimi domethënë punë të pavarur. Nëse çështja e pushimit të paguar për artistët nuk është e harmonizuar në nivel të BE dhe nëse Republika franceze ruan në parim, të drejtën për të siguruar një mbrojtje të tillë, duhet gjithsesi të theksohet se e drejta për të paguar pushimet për ofruesit e shërbimeve është e vështirë për tu pajtuar me konceptin e një aktiviteti si i pavarur. Si karakteristikë të fundit në lidhje me shërbimin kemi kohëzgjatjen e përkohshme në qarkullimin e tij në TUE. Karakteri i përkohshëm i një shërbimi nuk varet domosdo nga kohëzgjatja pak a shumë e shkurtër, por nga fakti që marrëdhënia kontraktore që vendoset mes ofruesit e destinatarit i referohet ushtrimit të një aktiviteti të kufizuar në kohë dhe një afati të parashikueshëm. Një përcaktim të tillë, GJED-ja, e pohon në vendimin Bruno Schnitzer të vitit 2003 ku shprehet se : “Karakterit i përkohshëm i aktivitetit të ofruesit në shtetin anëtar pritisë është për tu vlerësuar jo vetëm në funksion të afatit të shërbimit por njëkohësisht në funksion të frekuencës, periodicitetit, ose vazhdimësisë. Në lidhje me këtë përkufizim dhe tipare të konceptit shërbim në TUE është konsultuar një literaturë e gjerë dhe përmendim/ Mattera.A.,Le marché unique européen, ses libertés fondamentales, ses politiques d'accompagnement. Syllabus schematisé, A.A.2008/2009, fq.216-222; Craig.P.,De Burca.G.,EU law text cases and materials, fifth edition, Oxford University Press 2011, fq.788-797; Tesauro.G., Diritto dell'Unione European, Sesta edizione, Cedam, casa editrice dott.Antonio Milani, 2010, fq. fq.582. Canaj E, Bana S. (2014). E Drejta e Bashkimit Evropian. Tiranë: Onufri fq. 237-240.

Për më tepër shih; Progres Raporti 2009 në <http://www.mie.gov.al/>.

4. Analiza e gjetjeve

Në radhe të parë lind pyetja se kush janë subjektet apo përfituesit e ofrimit dhe të përftimit/marrjes së shërbimeve në Tregun Unik? Kush janë importuesit apo eksportuesit e shërbimeve siç ndonjëherë në literaturën e së drejtës së BE-së iu referohet atyre? Subjektet e lirisë së qarkullimit të shërbimeve i ndajmë në dy grupe: persona fizikë dhe persona juridikë.

Personat fizikë për të qenë subjekte të lirisë së lëvizjes së shërbimeve duhet të plotësojnë dy kriteret të rëndësishme: të jenë shtetas të shteteve anëtare të BE-së; të jenë të vendosur/banues brenda Bashkimit (neni 56 TFBE dhe titulli I-rë i Programit të Përgjithshëm)¹¹. Edhe tek personat fizikë dallojmë ofruet të shërbimeve që janë persona të vetëpunësuar dhe të vendosur në BE, dhe marrës të shërbimeve siç kemi përmendur tek llojet e shërbimeve veçanërisht, turistët, personat që marrin trajtime mjekësore jashtë vendit të tyre, dhe persona që udhëtojnë për qëllime biznesi apo studimesh. Kur personat fizikë nuk janë persona të vetëpunësuar, ata nuk mund të jenë “të vendosur” në kuptimin e fjalës “vendosje”. Ndërsa për sa i përket personave juridikë, “shoqëritë tregtare ose firmat” janë sipas nenit 54 (2), shoqëri tregtare ose firma të regjistruara sipas të drejtës civile apo tregtare, duke përfshirë edhe shoqëritë e formës kooperativë si dhe personat e tjerë juridikë që i rregullon e drejta publike apo private, me përjashtim të atyre që janë jofitimprurëse”. Prandaj sipas interpretimit të këtij neni përjashtohen nga të qenit subjekte të lirisë së shërbimeve në TFBE, shoqëritë jofitimprurëse, sepse ato veprojnë pa interes ekonomik apo përfitime që janë baza kryesore e përkufizimit të qarkullimit të shërbimeve. Këto firma apo kompani për të përfituar nga klauzolat e lëvizjes së lirë të shërbimeve duhet të jenë të themeluara sipas ligjit të një shteti anëtar dhe të kenë zyrën e tyre të regjistruar, administratën qendrore apo vendin e tyre kryesor të biznesit brenda Bashkimit, neni 54 (1). Përveç kësaj, Titulli I-rë i Programit të Përgjithshëm, kërkon që ato të shfaqin një lidhje të vërtetë e të vazhdueshme me ekonominë e një shteti anëtar të ndryshëm nga ai i shtetësisë së tyre.

Studentët janë destinatarë të shërbimeve sipas direktivës 2004/38. Kjo direktivë iu jep të drejtën e qëndrimit në BE studentëve, pasi ato plotësojnë disa kushte, ndër të cilat sigurimi i autoriteteve të shtetit pritës se kanë mjete të mjaftueshme jetese për veten e tyre dhe familjen, që janë të përfshirë në një kurs trajnimi profesional të njohur ose universitet dhe janë të mbuluar me sigurimin e sëmundjeve. Kështu studentët përfitojnë të drejtën e qëndrimit e cila është me rëndësi të madhe për to pasi iu lejon të pranohen në universitete apo institucione të tjera të arsimit të lartë¹², dhe avantazheve që iu jepen studentëve në vendin e qëndrimit/rezidencës¹³. Por, përfitues siç thamë edhe në fillim, në lidhje me klauzolat e lëvizjes së lirë të shërbimeve janë edhe shtetasit e vendeve të treta të cilët, në parim, përfitojnë nga liria e lëvizjes së shërbimeve sipas një Vendimi të Këshillit të miratuar sipas nenit 56 (2) ose sipas çdo marrëveshjeje ndërkombëtare të përfunduar mes Bashkimit dhe vendeve të tyre të origjinës, dhe që shumë prej këtyre marrëveshjeve parashikojnë “trajtimin jodiskriminues” dhe “trajtimin jo më pak të favorshëm” se ai i bërë ndaj shtetasve të BE-së.

Sa i takon progresit të vendit tone lidhur me lirinë e ofrimit të shërbimeve, fokusi do të jete kryesisht, sic u theksua, në periudhën nga viti 2010 deri në 2012 ku vihet re progres evident për të përmbushur detyrimet e MSA-së lidhur me këto fusha:

Përsa i përket të drejtës së vendosjes legjislacioni shqiptar nuk diskriminon operatorët e huaj, shoqëritë e kontrolluara, degët e filialet e tyre dhe procedurat për regjistrimin në regjistrin tregtar nuk janë diskriminuese.

Tek shërbimet postare ka arritje të konsiderueshme, pasi legjislacioni parësor shqiptar zbaton parimet dhe objektivat e acquis-së, dhe strategjia postare dhe vendimi mbi përcaktimin e tarifave dhe rëndësinë e shërbimeve të rezervuara në postën publike është në fazën e përgatitjes. Këshilli i Ministrave ka aprovuar rregulloren për përcaktimin e procedurave të përgjithshme të lëshimit të licencave, si dhe përmbajtjen dhe kushtet për ndryshimin, pezullimin apo revokimin e tyre.

Në lidhje me njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale, qëllimi dhe kërkesat minimale për trajnimin për profesionet e rregulluara janë gjerësisht në pajtim me acquis-në dhe qeveria ka përcaktuar disa masa administrative për provimin e detyrueshëm të shtetit të profesioneve të rregulluara si: doktor, dentist, farmacist, infermier, mami, fizioterapist, arkitekt, mësues dhe inxhinier. Në dhjetor të 2010 u themelua Agjencia Kombëtare e Provimeve e cila është e mbikëqyrur nga Ministria e Arsimit dhe është përgjegjëse për organizimin dhe monitorimin e këtyre provimeve. Profesionistët plotësisht të kualifikuar nga vendet e huaja janë të përjashtuar nga provimet dhe kanë të drejtë të ushtrojnë profesionin e tyre në Shqipëri në përputhje me kuadrin e zbatueshëm ligjor dhe nën të njëjtat kushte si shtetasit shqiptarë¹⁴.

Në këto dy vitet e fundit:

Në fushën e të drejtës së vendosjes, janë bërë hapa në lidhje me përgatitjet për thjeshtësimin e procedurave dhe shkurtimin e procesit të marrjes së lejeve të ndërtimit¹⁵.

Për sa i përket lirisë së ofrimit të shërbimeve ndërkufitare, në vitin 2013 u ngritë një grup pune ndërministror dhe në prill të po këtij viti është miratuar udhërrëfytyruesi për përafrimin e legjislacionit për shërbimet ndërkufitare me Direktivën e Shërbimeve. Në vitin 2014 kemi finalizimin e legjislacionit në fushën e çminimit, me synimin për ta përgatitur për

¹¹ Toth. A.G., The Oxford Encyclopaedia of European Community Law, volume II The law of the Internal market, Oxford University Press, 2005, fq.323-324.

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:62003J0147:EN:HTML>.

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:62003J0209:EN:HTML>.

Për më tepër shih; Progres Raporti 2010 në <http://www.mie.gov.al/>; Progres Raporti 2011 në <http://www.mie.gov.al/>.

Për më tepër shih; Progres Raporti 2010 në <http://www.mie.gov.al/>; Progres Raporti 2011 në <http://www.mie.gov.al/>.

përafrim me Direktivën e Shërbimeve. Manualët për testet e proporcionalitetit, që do të përdoren nga institucionet e linjës gjatë përdorimit të mëtejshëm, janë përgatitur, për lojërat e fatit, sektorin farmaceutik dhe tatim-taksat.

Në fushën e shërbimeve postare, Strategjia Kombëtare e Shërbimit Postar u miratua në korrik të vitit 2013¹⁶. Liberalizimi i shërbimeve postare avancoi me reduktimin e zonës së rezervuar postare nga 100 g. në 50 gr. në gusht. Në vitin 2014 struktura e re organizative e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare është miratuar, si dhe drejtoria për rregullimin e tregut postar është ngritur dhe është plotësuar me staf.

Në fushën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale, në vitin 2013 u miratuan akte nënligjore që heqin detyrimin e dhënies së provimit shtetëror për personat e profesioneve të rregulluara¹⁷, të cilët kanë marrë me sukses provimin shtetëror në një nga shtetet anëtare të BE-së, vendet EFTA, SHBA ose në një sërë vendesh të tjera. Ndërsa viti 2014 na sjell miratimin e masave legjislative për të përfshirë profesionet e punonjësit social dhe psikologut në listën e profesioneve të rregulluara, ndërsa dispozitat për arkitektët dhe inxhinierët mbeten për t'u miratuar. Është shkurtuar koha e përpunimit të aplikimeve për njohjen e diplomave akademike dhe profesionale të lëshuara nga institucione përkatëse të huaja. Është ecur përpara me përgatitjet e futjes së aplikimit online për këto njohje¹⁸.

Probleme të cilat kërkojnë ende vëmendje lidhur me lëvizjen e lirë të shërbimeve: Problemet të cilat evidentohen edhe nga Komisioni Europian në raportin e viti 2014, që është dhe i fundit aktualisht, lidhur me lëvizjen e lirë e shërbimeve në Tregun Europian janë disa. Situata në vend lidhur me kete të drejte prezanton disa një lloj stanjacioni në progresin dhe në zbatimin e rekomandimeve që mbarten që nga vitin 2013 pasi legjislacioni ende nuk është i përafuar me *acquis*. Më poshtë do të evidentojmë problemet në lidhje me lirinë e ofrimit të shërbimeve:

Ka pasur përparim të kufizuar me krijimin e një plani veprimi për përputhjen e Direktivës së Shërbimeve në fushën e lirisë të ofrimit të shërbimeve ndërkufitare por nuk ka pasur po aq përparim në atë që u kërkuar me forcë edhe në raportet e fundit, në drejtim të miratimit të kuadrit institucional dhe zhvillimi i kapaciteteve të mjaftueshme me institucionet përkatëse është në një fazë shumë të hershme. Ndaj Komisioni Europian vë theksin që në këtë pikë legjislacioni shqiptar nuk është në linjë me *acquis*. Përgatitjet nuk po avancojnë, pasi legjislacioni në fuqi rregullon dispozitat për shërbimin nëpërmjet vendosjes në Shqipëri, por jo dispozitat për ofrimin e shërbimeve ndërkufitare.

Progres Raportet vërejnë që nuk ka pasur përparim për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Postës apo me përcaktimin e tarifave dhe peshave për shërbime të veçanta për operatorin publik të postës dhe nuk ka një ndarje të funksioneve rregullatore nga kontrolli i politik-bërjes dhe ushtrimit të pronësisë në sektorin postar¹⁹. Në fushën e shërbimeve postare ka akoma një numër çështjesh specifike lidhur me detyrimet e shërbimit universal që kërkojnë vëmendje të veçantë, si për shembull llojet e produktit dhe kërkesat minimale, përjashtimi nga TVSH-ja, përjashtimet nga detyrimi dhe periudha për caktimin dhe mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimit.

Në lidhje me njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale Shqipëria ka ende një rrugë shumë të gjatë për të bërë për përafrimin e legjislacionit. Komisioni shprehet se kërkesat minimale për trajnimin duhet të përshtaten për të arritur pajtueshmërinë e plotë me *acquis*-në. Disa akte nënligjore për njohjen e kualifikimeve profesionale janë ende të vonuara. Nuk ka një ndarje të qartë midis njohjes së kualifikimeve profesionale dhe njohjes së kualifikimeve akademike dhe kapacitetet administrative nuk janë të mjaftueshme në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për transpozimin e plotë të *acquis* dhe vendosjen e një kuadri institucional të përshtatshëm⁵. Përafrimi i legjislacionit shqiptar me direktivën "Për shërbimet" është në një fazë gati fillestare.

Konkluzione

Nga analiza e kryer për lëvizjen e lirë të shërbimeve në vendin tonë vërehet se në lidhje me përfaqesën e harmonizimit të *acquis* së lëvizjes së lirë të shërbimeve në vitet 2010-2014 ka progres evident pasi legjislacioni shqiptar nuk diskriminon operatorët e huaj, shoqëritë e kontrolluara, degët e filialet e tyre dhe procedurat për regjistrimin në regjistrin tregtar nuk janë diskriminuese, janë bërë hapa në lidhje me përgatitjet për thjeshtësimin e procedurave dhe shkurtimin e procesit të marrjes së lejeve të ndërtimit. Ndërkohë, mosqenia e legjislacionit shqiptar në linjë me *acquis*, veçanërisht me Direktivën e Shërbimeve dhe transpozimi i ende i përcaktuar i plotësisht i direktivës së shërbimeve, duke përfshirë zhvillimin e kapaciteteve të përshtatshme administrative nuk e ben të kënaqshme kete situatë.

Nga ana tjetër, konkretisht tek shërbimet postare ka arritje të konsiderueshme, pasi legjislacioni parësor shqiptar zbaton parimet dhe objektivat e *acquis*-së, dhe strategjia postare dhe vendimi mbi përcaktimin e tarifave dhe rëndësinë e shërbimeve të rezervuara në postën publike është në fazën e përgatitjes. Në vitin 2014 struktura e re organizative e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare është miratuar, si dhe drejtoria për rregullimin e tregut postar është ngritur dhe është plotësuar me staf.

Në fushën e shërbimeve postare, veçse, mbeten një numër çështjesh specifike lidhur me detyrimet e

Progres Raporti 2013 në <http://www.mie.gov.al/>.

Një profesion i rregulluar sipas nenit 1(c) dhe (d) të direktivës 89/48/KEE është ai profesion që rregullat kombëtare (qoftë legjislacioni, rregulloret apo dispozitat administrative) të cilat drejtojnë/rregullojnë kushtet për marrjen përsipër apo ndjekjen e aktivitetit profesional vendas imponojnë zotërimin e një diplome apo një certifikatë tjetër të kualifikimit si një parakusht për ushtrimin e atij profesioni.

Për më tepër shih: Progres Raporti 2014 në <http://www.mie.gov.al/>.

Po aty.

shërbimit universal që kërkojnë vëmendje të veçantë, si për shembull llojet e produktit dhe kërkesat minimale, përjashtimi nga TVSH-ja, përjashtimet nga detyrimi dhe periudha për caktimin dhe mbikëqyrjen e ofruesit të shërbimit, gjithashtu nevoja në sektorin e shërbimit postar për të siguruar kapacitetet rregulluese, pavarësisht nga politik-bërja.

Në lidhje me njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale, në dhjetor të 2010 u themelua Agjencia Kombëtare e Provimeve e cila është e mbikëqyrtur nga Ministria e Arsimit dhe është përgjegjëse për organizimin dhe monitorimin e këtyre provimeve. Në vitin 2013 u miratuan akte nënligjore që heqin detyrimin e dhënies së provimit shtetëror për personat e profesioneve të rregulluara, të cilët kanë marrë me sukses provimin shtetëror në një nga shtetet anëtare të BE-së, vendet EFTA, SHBA ose në një sërë vendesh të tjera. Profesionistët plotësisht të kualifikuar nga vendet e huaja janë të përjashtuar nga provimet dhe kanë të drejtë të ushtrojnë profesionin e tyre në Shqipëri në përputhje me kuadrin e zbatueshëm ligjor dhe nën të njëjtat kushte si shtetasit shqiptarë. Këtë dukuri tashmë të lëvizjes së profesionistëve të BE në Shqipëri e shohim tek mjekët, arkitektët, që kanë migruar për arsye të gjetjes së një tregu më të favorshëm për ushtrimin e profesionit të tyre. Është shkurtuar koha e përpunimit të aplikimeve për njohjen e diplomave akademike dhe profesionale të lëshuara nga institucione përkatëse të huaja. Është ecur përpara me përgatitjet e futjes së aplikimit online për këto njohje. Sa i takon kësaj fushe kërkesat minimale për trajnimin duhet të përshtaten për të arritur pajtueshmërinë e plotë me acquis-në. Disa kërkesa për shtetasit e BE-së për të praktikuar profesionin në sektorin e shëndetësisë nuk janë në linjë me acquis-në. Nuk ka një ndarje të qartë midis njohjes së kualifikimeve profesionale dhe njohjes së kualifikimeve akademike dhe kapacitetet administrative nuk janë të mjaftueshme në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për transpozimin e plotë të acquis dhe vendosjen e një kuadri institucional të përshtatshëm. Gjithashtu duhen përpjekje të mëtejshme për përafrimin e legjislacionit postar me atë komunitar pasi në 3 raportet e fundit përsëriten pothuajse të njëjtat vërejtje e mangësi ecurish. Pavarësisht se ky raport për progreset në fushën e përjasjes me dispozitat për shërbimet dhe vendosjen paraqet sfidat e ardhshme që duhet të kapërcejë shteti shqiptar, në tërësi, përgatitjet sipas Komisionit kanë avancuar në masë të moderuar. Kjo është një lloj inkurajimi për të vazhduar reformat e përbushjen e detyrimeve dhe angazhimeve në kuadër të MSA-së.

Në perspektivën e ardhshme të anëtarësimit dhe zbatimit të klauzolave të TUE përjashtimi me klauzolat e lirisë së ofrimit të shërbimeve për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor luan një rol me rëndësi të ecuria e kriterit të acquis-së sepse një pjesë thelbësore e sektorëve të ekonomisë janë tek shërbimet dhe si të tilla balancojnë edhe ecuritë në liritë e tjera komunitare. Shqipëria në përparimin e saj në këtë fushë krahasohet me Maqedoninë dhe Malin e Zi për sa i përket avancimit të vlerësuar nga Komisioni si i moderuar, në disa pike kyçe të acquis-së për shërbimet, të transpozuar dhe zbatuar sipas traktatit apo akteve komunitare. Ndërsa Serbia dhe Bosnja janë mesatarisht të avancuar, dhe sipas vlerësimit të raporteve të fundit të bërë nga Komisioni mund të thuhet se Shqipëria është konkurrese për progres dhe ndoshta nëse do të ketë ecuri të tillë të vazhdueshme, kuptohet edhe në krerët e tjerë të acquis-së (pa të cilët nuk quhet i zbatuar tërësisht kriteri i acquis, përpos kriterit politik dhe ekonomik), që të demonstrojë përbushjen e detyrimeve të MSA-së.

Bibliografia

- Direktiva 2005/36 në <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CONSLEG:2005L0036:20090427:F R:PDF FYROM>
Progress Report 2011 në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/mk_rapport_2011_en.pdf
Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit për Shqipërinë <http://www.mie.gov.al/>, dhe http://ec.europa.eu/enlargement/countries/detailed-country-information/albania/index_en.htm
Progres Raporti 2009 në <http://www.mie.gov.al/>
Progres Raporti 2010 Shqipërisë në <http://www.mie.gov.al/>
Progres Raporti 2011 Shqipërisë në <http://www.mie.gov.al/>
Progres Raporti 2012 Shqipërisë në <http://www.mie.gov.al/>
Progres Raporti 2013 Shqipërisë në <http://www.mie.gov.al/>
Progres Raporti 2014 Shqipërisë në <http://www.mie.gov.al/>
Andenas Mads, Wooldridge Frank, European Comparative Company Law, Cambridge University Press,
2009 Canaj E, Bana S. (2014). E Drejta e Bashkimit Evropian. Tiranë: Onufri fq. 237-240.
Carsten Gerner-Beuerle and Michael Schillig, Mysteries of freedom of establishment after Cartesio, volume 59, April 2010
Chalmers Damian, Davies Gareth, Monti Giorgio, European Union Law, second edition, Cambridge University Press, 2010
Communication on the implementation of the Services Directive, A partnership for new growth in services 2012-2015 në http://ec.europa.eu/internal_market/services/docs/services-dir/implementation/report/COM_2012_261_en.pdf
Craig Paul, De Burca Grainne, EU law text cases and materials, fifth edition, Oxford University Press 2011
Daniele Luigi, Diritto del mercato unico europeo, Milano, Giuffrè editore, 2012
Evaluation of the legal framework for the free movement of lawyers, Executive summary, Maastricht University, Zoetermeer, December 18, 2012
Fabrizio Bano., Diritto del lavoro e libera prestazione dei servizi, 2012 http://ec.europa.eu/internal_market/services/services-dir/background_en.htm
Jacques Pelkmans, Mutual Recognition: economic and regulatory logic in goods and services, Bruges European Economic Research Papers, 24 / 2012.
Klaus-Dieter Borchardt, ABC-ja e së Drejtës së Bashkimit Evropian botim i Ministrisë së Integritetit, 2011
Lenaerts Koen and Van Nuffel Piet, Bray Robert editor, Constitutional Law of the European union, second edition, Thompson Sweet and Maxwell
Paul Craig and Grainne de Burca, The evolution of EU law. Oxford 2011
Tesauro Giuseppe, Diritto dell'Unione Europea, Sesta Edizione Cedam, casa editrice dott. Antonio Milani, 2010.

APLIKIMI I MENAXHIMIT STRATEGJIK NË EKONOMIT NË ZHVILLIM, TREGU I SHQIPËRISË DHE KOSOVËS

RREZARTA GASHI, PHD CANDIDAT

Universiteti European i Tiranës

rezartag@gmail.com

ABSTRAKT

Në vitet 1990'ta ashtu si në gjithë botën edhe në Shqipëri e Kosovë filloi rënia e sistemit të ekonomisë së planifikimit të centralizuar- monist, kështu në Shqipëri u krijuan kushte favorizuese për lindjen e ekonomisë së tregut, duke u hapur rruga për rritjen dhe zhvillimin e sektorit privat i cili u realizua nëpërmjet disa formave si, privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore/ shtetërore, rritja dhe zgjerimi i bizneseve të vogla dhe të mesme kryesisht familjare, dhe themelimi i ndërmarrjeve të reja private, kjo etapë në Kosovë përkundër lindjes së ekonomisë së tregut në vitet 90, hovin e merr në fillim të shekullin XXI, pas çlirimit. Këto biznese e ndien nevojën e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm, kusht për këtë ishte planifikimi, vlerësimi i kujdesshëm dhe shfrytëzimi i suksesshëm i instrumenteve dhe teknikave zhvillimore. Në situatë të tillë bizneset private bashkërisht me ndërmarrjet publike, në ekonomitë në zhvillim duhet të zhvillojnë strategji unike; mbështetur në tri perspektiva teorike kryesore: ajo institucionale, ekonomia e kostos së transaksioneve, dhe perspektiva ndërmarrëse, në mënyrë që të përballojnë ndryshimet rrënjësore dhe rapid të gjendjes politiko-ekonomike. Nga dinamika rapide zhvillimore lind domosdoshmëria e menaxhimit strategjik, si inovacion për këto ekonomi, duke u shndërruar në perceptimin bazik për zhvillimin e ekonomisë nacionale dhe të kompanive. Menaxhimi Strategjike përfaqëson kështu tërësinë e mekanizmave dhe aftësive për të hartuar, zbatuar dhe analizuar vendimet e rëndësishme funksionale, të cilat do të mundësonin arritjen e objektivave afatgjate të kompanive në këto vende.

Fjalë kyç: *strategji, zhvillim, ekonomi, qeveri, menaxhim*

1. Hyrje

Përmes konsultimit të literaturës së përgjithshme, nga lëmia e aplikimit të menaxhimit strategjik në Kosovë dhe Shqipëri në veçanti.

Në shërbim të menaxhimit strategjik do të paraqes në pika të shkurtëra atë që bartësit e menaxhimit strategjik të ndërmarrjeve duhet të dinë nëse tentojnë të zhvillojnë Menaxhimin Strategjik në përditshmërinë e tyre të të bërit biznes.

Në kushtet e ekonomisë së tregut, firmat për të konceptuar dhe implementuar politikën afariste afatgjate, afatmesme dhe afatshkurtër, duhet të hartojnë dhe menaxhojnë strategjitë e tyre të cilat do të jenë të qëndrueshme në treg, me rivalët apo konkurrencën në përgjithësi.

Në periudhën në të cilën po kalojmë, në procesin e globalizimit të ekonomisë botërore, do të jetë e pamundur të ketë siguri në investime, prodhim, shitje, sigurim të fitimit, pa e menaxhuar mirë të ardhmen e ndërmarrjes.

“Menaxherë efektiv jetojnë në të tashmen – por koncentrohen në të ardhmen (James L. Hayes).

Menaxhimi Strategjik është procesi i formulimit, implementimit dhe vlerësimit të strategjive për të përmbushur objektivat afatgjata dhe duke mbështetur avantazhin konkurrues.

2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi bazik dhe fundamental në realizimin e këtij studimi është shqyrtimi i rëndësisë së aktiviteteve të menaxhimit strategjik në sektorin ekonomik në tregjet në zhvillim me theks të veçantë tregjet e Kosovës dhe Shqipërisë, aktivitete këto me vet-objektivë të zhvillimit të kapaciteteve për zhvillimin ekonomik lokal, për të përmirësuar të ardhmen ekonomike dhe cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët. Objektivat bazike të studimit janë:

Të studiohen dhe vlerësohen faktorët historik etimologjik dhe funksional që ndikojnë në ngritje të zhvillimit të sipërmarrjeve dhe menaxhimit strategjik;

Të identifikohen fushat ku takohen aktivitetet e sipërmarrjes dhe menaxhimit strategjik drejt arritjes së pasurisë së firmave, me theks të veçantë në kushtet e ekonomisë së tregut, si dhe sfidat e zhvillimit të ekonomive bashkëkohore;

Të përcaktohen efektet e aplikimit të këtij modeli në praktikën konkrete të zhvillimit të ndërmarrjeve në tregjet në shqyrtim. Rezultatet e aplikimit të këtij modeli të shërbejnë për nxitjen e zhvillimit të këtij sektori dhe ekonomive lokale si dhe matjen e performancës së menaxhimit/implementimit të aktiviteteve strategjike.

Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Pyetjet kërkimore në funksion të realizimit të suksesshëm të punimit, përmbushjes së qëllimeve, objektiveve dhe valorizimit të hipotezës janë:

Me çfarë peripecish janë përballur tregu i Kosovës dhe Shqipërisë dhe si qëndron ai tani?

A e aplikojnë ndërmarrjet vendore në tregun e Kosovës dhe Shqipërisë Menaxhimin Strategjik?

Si ka ndikuar Menaxhimi Strategjik në përmirësimin e performancës, rritjes së fitimit për ndërmarrjet?

Si kanë ndikuar ndërmarrjet që e aplikojnë Menaxhimin Strategjik në zhvillimin e tregut dhe ekonomive në zhvillim/ tranzicion me theks të veçantë tregun dhe ekonominë Kosovare dhe Shqiptare.

Hipoteza- Zhvillimi i aktiviteteve të Menaxhimit Strategjik ndikon në pasurimin e ndërmarrjeve të cilat e aplikojnë atë, dhe në zhvillimin ekonomik të vendit

Metoda e realizimit të studimit është mbledhja e të dhënave, shifrave, fakteve dhe informacioneve nga burime të ndryshme, kryesisht burime primare, seleksionim i tyre dhe më tej përpunimi i tyre për të realizuar draftin e parë të diskutimit. Më tej materiali është rishikuar disa herë deri në realizimin e një varianti përfundimtar që është ky shkrim dhe mbi këtë bazë janë nxjerrë konkluzionet dhe mbi bazën e tyre edhe rekomandimet.

Filozofia e kërkimit në kuadër të ndërtimit të këtij punimi është zhvilluar në aspektin teorik- shkencor, empirik.

Modeli i kërkimit është plotësisht përfaqësues dhe sipas rasteve studimore i dizajnuar me qëllim përfitimi të rezultateve më të mira nga studimi i lartpërmendur.

Kryesisht konkluzionet e punimit do të koncentrohen në reduktimin e të dhënave dhe shkallën e besueshmërisë (Alpha Cronbach: < 0.70) - Analizën e Aplikimit të Menaxhimit strategjik në ekonominë në zhvillim, tregu i Shqipërisë dhe Kosovës.

Do të përdoret modeli ekonometrik logjik;

$$P(y=1|x) = b_0 + b_1x_1 + \dots + b_kx_k$$

Analiza e të dhënave do të bëhet nga rezultatet që dalin nga kërkimi me 488 ndërmarrje ekonomike, si dhe analizës së faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e menaxhimit strategjik në këto ndërmarrje me target fokusimi zhvillimin ekonomik të ekonomive të Kosovës dhe Shqipërisë.

4. Analizë, interpretim të dhënash

Me fillimin e rënies së sistemit ekonomik socialist në fillim të dekadës së fundit të shekullit të kaluar, u hap rruga për rritjen e zhvillimit të sektorit privat nëpërmjet disa formave si, privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore, rritja dhe zgjerimi i bizneseve të vogla kryesisht familjare, dhe themelimi i ndërmarrjeve të reja private. Themelimi dhe rritja e ndërmarrjeve të reja private, nuk ishte i lehtë ose pa sfida të mëdha në shtetet e tranzicionit. Në fillim të viteve 1990-të u bënë shumë hulumtime teorike dhe empirike për të treguar efikasitetin e ulët të sistemit të planifikimit në sistemin e vendeve socialiste. Mungesa ose kufizimi i sipërmarrjes private, braktisja e atij sistemi dhe kalimi në sistemin e ekonomisë së tregut dhe iniciativës së lirë private, vërtetuan se në dekadën e parë të tranzicionit pritet nga përmirësimi i dukshëm i performancës ekonomike të këtyre vendeve në nivelin makro dhe mikro dolën dëshpëruese (Roland, 2000).

Ndryshimet sistematike të cilat ndodhën në ekonominë në tranzicion hapën mundësitë për zhvillimin e Sipërmarrjes. Si rezultat i heqjes së kufizimeve ligjore për sipërmarrjen private në ekonominë në tranzicion, sipërmarrësit e ndryshëm filluan rrugën e transformimit në faza dhe mënyra të ndryshme. Kuptohet që në fillim këta sipërmarrës zotëronin biznese të vogla dhe shumë pak të orientuar kah rritja. Në fillim këta sipërmarrës ishin të orientuar më shumë nga tregtia dhe sektori shërbyes, që më vonë në etapat tjera të tranzicionit të shndërrohen nga shitësit e vegjël më synim të angazhimit në aktivitetet ekonomike afat gjate. Dallimi ndërmjet

këtyre dy llojeve të Sipërmarrësve është shumë i rëndësishëm për propozimet e politikë bërjes në promovimin e Sipërmarrjes dhe rritjen e tyre në etapa të ndryshme të tranzicionit. Pra, me këtë rast duhet patjetër të theksojmë dhe të njohim rolin e institucioneve qeveritare në promovimin e sipërmarrjes dhe sidomos të sektorëve kyç për zhvillimin esencial të vendit.

Shumë shpejt u vërtetua se, nëse shteti si sipërmarrës nuk ishte më i mirë se sa privatët, roli i ridefinuar i tij në krijimin e kushteve për sipërmarrësi private është crucial. Madje, nga euforia fillestare për ardhjen e ekonomisë së tregut dhe lirisë ekonomike, u shkaktua një krizë e papritur që shumë pak njerëz e kishin menduar. U bë e qartë se liria për t'u marrë me sipërmarrësi në kushtet e heqjes së kufizimeve shtetërore nuk do të thotë se shteti dhe institucionet nuk duhet të jenë aktiv si rregullator, përndryshe gjendja e kaosit sipërmarrës mund të zgjasë.

Peng (2003), bëri një studim interesant duke zbatuar teorinë institucionale në kontekstin e ekonomive në zhvillim.

Reagimi i firmave të ekonomive në tranzicion ndaj sistemit ekonomik të bazuar në treg bëhet në dy mënyra apo faza:

Së pari firmat miratojnë një strategji të bazuar në rrjetëzim, që lehtëson lidhjet ndërpersonale të menaxherëve dhe marrëdhëniet inter-organizative të firmave (Poëell, 1990) me ndërtimin e marrëdhënieve me autoritetet qeveritare (Guillen, 2000; Hillman dhe Hitt, 1999). Duke vepruar kështu, firmat nuk iniciojnë në mënyrë aktive transformimet strategjike, por kryesisht reagojnë ndaj krizës ekzistuese me shpresë se do ta kalojnë tranzicionin me ndryshime minimale (McCarthy dhe Puffer, 1995). Peng ofron shembullin e Indisë në fund të viteve 90-së, ku grupe të themeluara të biznesit u përballen me politika liberalizuese të qeverisë dhe u zgjeruan në mënyrë të konsiderueshme në vend të reduktimit të fushë-veprimit të tyre duke i zgjeruar lidhjet e rrjetit të tyre me më shumë sektorë të ekonomisë (Khanna dhe Palepu, 1999).

Me kalimin e kohës, presionet e njohura rregullative dhe normative i nxisin këto firma për të zhvilluar aftësitë organizative duke u mbështetur më pak në rrjetëzim për krijimin e avantazheve të tyre konkurruese (Scott, 1995). Gjithashtu, kjo nxitje iu referua strategjisë së bazuar në treg, të koncentruar në burime dhe aftësive konkurruese si cilësia, financat, marketingu, etj, marrëdhënie të cilat janë të pavarura nga rrjetëzimi, (Barney, 1991). Nxitja për një strategji të bazuar në treg i çon firmat drejt "heqjes nga mendja" të rutinave organizative (Oliver, 1992, faqe 585). Përveç kësaj, sukcesi i "start ups" vendore dhe kompanive të huaja inkurajojnë disa prej kandidatëve të stimulohen drejt ndjekjes së strategjive të bazuara në aftësi (Lyles dhe Salk, 1996; Shenkar dhe Li, 1999).

4.1. Tranzicioni në tregun ekonomik në Kosovë dhe Shqipëri

Tranzicioni si proces, i nisur në fund të shekullit XX në të dy vendet, Kosovë dhe Shqipëri, por edhe në vendet e Bllokut Lindor dhe të Evropës Qendrore, kishte për pasojë rënien e sistemit socialist në këto vende. Shpërbërja e RFSJ, dhe futja e Kosovës në administrimin e dhunshëm të Serbisë e ka shkatërruar sistemin ekonomik dhe atë bankar edhe ashtu te pa qëndrueshëm që e kishte Kosova në kuadër të ish shtetit Jugosllav.


Vitet e 80'ta në Shqipëri u karakterizuan me ritme shume të ulëta të zhvillimit ekonomik duke kaluar nga viti dhe në fund të sajë u realizua rënia më e madhe ekonomike, ku prodhimi shënonte një shkallë të lartë deficitit, eksporti u minimizua së tepërmi, deficitit bankar kaloi në shkallë kronike si rrjedhojë e mungesës së pagesave, ndërmarrjet ekonomike punonin nën kapacitetet e tyre normale- dhe në shumë raste u aplikua pagesa e rrogës në shkallën prej 80% si rrjedhojë e mos daljes në punë pasi që mungonin furnizimet me lëndën e parë, përpunuese, bujqësia shënonte rënie drastike të prodhimit dhe furnizimit, u vendos racionimi i ushqimeve; ndërmarrjet ose kooperativat bujqësore për mungese të aftësisë paguese bllokuan njëra-tjetrën, deficitit buxhetor rritej me hapa galopant. Këto dhe bllokime të tjera çuan në kolaps të plote të ekonomisë së vendit.

Vitet '90 të shekullit të kaluar përvijohen nga dy periudha, në të cilat fenomenet e vërejtura janë përsëritur me të njëjtën skemë veprimi, ndonëse me përmasa të ndryshme. Në të dyja këto periudha (vitet 1991-1995 dhe 1996-1999) është evidentuar fenomeni "shturje-stabilizim". Në të dyja rastet, rënia e madhe ekonomike, përsheptimi i inflacionit, thellimi i deficitit kronik, në përgjithësi kriza ekonomiko-financiare është vënë nën kontroll nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të programeve emergjente gjashtëmujore. (Banka e Shqipërisë)

Në fillim të viteve 90'ta në ekonominë shqiptare u paraqiten nismat e ndryshimeve strukturale ekonomike, ku në vend të pronësisë së plotë të shtetit mbi ndërmarrjet ekonomike dhe më gjerë u paraqit partneriteti publiko-privat apo tërësisht privat, ku deri në 90% të pronës është privatizuar tërësisht nga fundi i kësaj dekade.

Duke hapur kështu rrugën për liberalizimin e tregut vendor, dhe në këtë fushë Shqipëria qëndron shumë mirë.

GRAFIKU 1. RRITJA REALE EKONOMIKE- SHQIPËRI



Burimi: INSTAT - MF

Shqipëria realizoi reforma tërësore e transformuese në ekonomi që garantuan, përgjithësisht, gjatë kësaj periudhe, një stabilitet makroekonomik dhe një zhvillim të qëndrueshëm, edhe pse në situata të caktuara shumë të brishte. (me përjashtim të periudhës së krizës së skemave piramidale, 96-97, krizës politike të vitit 2002, dhe sidomos, vitet 2008-2009 ku rënia ekonomike është dukshëm e madhe, edhe për shkak të ndikimit të krizës globale)

Situatë nuk ishte e njëjtë në këto vite edhe në Kosovë sepse represioni serb në vitet 90 nga popullatës në përgjithësi shqiptare ishte i një shkalle shqetësuese, duke pasur kështu për rrjedhojë impakt të lartë në situatën ekonomike. Në këtë periudhë mbahen mend masat e dhunshme të instaluar në ndërmarrjet ekonomike të asaj kohe të cilat e shpion ekonominë vendase drejt një kollapsimi i cili ndodhi në fund të viteve 90.

Në fillim të shekullit të ri, pas çlirimit të Kosovës nga Serbia, në Kosovë u vendos një administratë e përkohshme ndërkombëtare, në ekonomi u iniciua modeli ekonomik i tregut të lirë, konkurrencës dhe liberalizimit.

Kosova për procesin e kalimit nga pronësia shtetërore në atë të konkurrencës ka zgjedhur strategjinë e privatizimit të ndërmarrjeve publike dhe shtetërore përmes procesit të spin-off it të rregullt dhe në disa raste atij special.

Vendimi i Qeverisë i vitit 2008 për rritje të nivelit të investimeve publike mbi 120% ka qenë shtytës kryesor për rritjen ekonomike. Veç kësaj, kjo zhvendosje e burimeve drejt investimeve publike ka qenë një stimulim për ekonominë në vitin 2009 duke mundur një rritje mbi 4 %, në një kohë kur shumica e vendeve të rajonit janë përballur me rënie ekonomike. Për shkak të nivelit relativisht të ulët të integritit të Kosovës në ekonominë globale dhe politikave të dobëta fiskale, ekonomia e saj ka qenë dukshëm e mbrojtur nga kriza ekonomike globale.

TABELA. 1 TREGUESIT KRYESOR MAKROEKONOMIK TË PLANIFIKUAR PËR 2008-2014, NË MIL/EURO

Përshkrim	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Konsumi	4345	4280	4760	5074	5336	5545	5819
Investimet	1094	1166	1213	1433	1620	1704	1756
Neto Eksporti	-1587	-1534	-1684	-1867	-1979	-2035	-2075
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	612	820	875	933	995	1049	1049
Importi i mallrave dhe shërbimeve	-2156	-2146	-2504	-2742	2912	-3030	-3124
BPV	3905	3912	4289	4639	4978	5214	5501
Rritja reale e BPV në %	6.9	2.9	4.0	5.3	5.1	5.4	6.0
BPV për kokë banori	1847	1848	1966	2127	2249	2321	2412
Inflacioni	9.2	-2.4	3.5	5.3	2.1	1.5	1.4

Burimi: Departamenti i Makroekonomisë, MF

Në të dyja vendet Kosovë dhe Shqipëri ka qenë aktual debati mbi modelin ekonomik i cili si debat as që ka nisur dhe as që do të përfundoj me Kosovën e Shqipërinë, përkundrazi janë pjese e mendimit ekonomik, dhe të shkollave ekonomike, të kohërave të ndryshme. Lidhur me zhvillimin e modeleve ekonomike janë të lidhur emrat e ekonomistëve më në famshëm në epokë të ndryshme, që nga Rikardo, Smith, Kejns, me pas Friedman, Samuelson, Leontjev dhe së fundmi edhe Krugman, Stiglic, Soros, etj. (Konferenca, Shqipëria: drejt një modeli të rë të zhvillimit ekonomik postranzicion)

Ndërtimi, zhvillimi i modeleve ekonomike plotësisht është i ndërthurur me përvojën e kaluar në fazën e tranzicionit në vendin përkatës, me zhvillimin dhe konsolidimin e grupeve, organizatave ekonomike ndërkombëtare dhe proceseve bashkëpunuese dhe integruese në ekonominë globale.

Përmes ndërtimit të modelit ekonomik të tregut të lirë dhe konkurrencës fere, të dy vendet ndërmorën reformat në strukturën ekonomike duke instaluar përfundimisht pronën private dhe ekonominë e tregut në vend. Veçanërisht pas vitit 2000 u ndërmorën hapa të rëndësishme në konsolidimin e mëtejshëm të reformës strukturore dhe konsolidimin e ekonomisë së lirë të tregut me anë të privatizimit të sektorit shtetëror përfshi dhe atë strategjik si dhe të kalimit të disa shërbimeve të rëndësishme nga sektori publik në atë private. Transformuan sistemin dhe politiken buxhetore dhe fiskale. Sistemi buxhetor dhe ai fiskal pësoj ndryshime thelbësore dhe iu përshtat standardeve të ekonomisë së tregut bazuar në ato më të mirat evropiane.

Ndërmarrjet e reja të krijuara si dalje nga reforma dhe modeli i tregut të lirë në Kosovë dhe Shqipëri në fillimet e tyre u përballën me luftimin e mentalitetit socialist, dhe tani së fundmi përballen me konkurrencën globale e cila imponon një menaxhim eficient, korret dhe me një performacë sa më të lartë, sipas një strategjie të miratuar paraprakisht.

Së këndejmi ndërtohet implementimi aplikativ i menaxhimit përmes strategjisë, apo thënë ndryshe menaxhimit strategjik në Kosovë dhe Shqipëri.

4.2. Zhvillimi i menaxhimit strategjik

Menaxhimi i strategjisë në ekonominë e perëndimit dhe sidomos në SHBA filloi të përdoret që nga vitet e 60-ta të shekullit të XX dhe kaloi nëpër tri faza. Faza e parë filloi në vitin 1960 deri në 1980. Faza e dytë ishte nga 1980 deri 1990, si dhe faza e tretë nga viti 1990 dhe vazhdon deri në ditët e sotshme.

Në secilën nga këto faza, profesionistët e zhvillimit të menaxhimit strategjik kanë tentuar të zhvillojnë programe të suksesshme por që gjithnjë nuk kanë pasur sukses të ia arrijnë këtij tentimi. Tani, zhvillimi i Menaxhimit Strategjik është në “fazën e tretë” të zhvillimit apo evoluimit të strategjive zhvillimore.

Çdo periudhë ka karakteristikat e veta të zhvillimit ekonomik dhe të sjelljes së ndërmarrjes. Kalimi i ndërmarrjeve prej konceptit si “sistem i mbyllur”, në “sistem të hapur” e sidomos ndikimi i mjedisit apo faktorëve të jashtëm e kanë kushtëzuar evoluimin e problematikës së programimit afatgjatë.

Sot, aplikohet menaxhimi strategjik për parashikimin e së ardhmes të organizatës apo firmës. Menaxhimi strategjik është rezultat i internacionalizimit të tregut, si formë e re e globalizimit të tregut botëror, që ka ndikuar në shkurtimin e ciklit jetësor të ndërmarrjes dhe të produkteve si rezultat edhe në ciklin jetësor të fitimit. Përfitimet nga të aplikuarit e menaxhimit strategjik janë: ndjenja e qartë e vizionit strategjik të kompanisë, fokusim i mprehtë në atë që është strategjikisht i rëndësishëm dhe të kuptuarit e një mjedisi që ndryshon me shpejtësi.

TABELA 2. FAZAT E ZHVILLIMIT TË MENAXHIMIT STRATEGJIK

Faza	Fokusi	Mjetet e përdorura
E para: 1960 deri të fillimi i vitit 198	Gjatë fazës së parë fokusi ishte si vijon: • Në tërheqjen e Investimeve në prodhimet mobile, • Tërheqja e investimeve nga jashtë, posaçërisht tërheqja e Investimeve të Huaja Direkte – IHD/FDI, • Investimet në infrastrukturën fizike	Për t'u arritur ky qëllim u përdorën: • Grante masive • Kreditë ndihmëse zakonisht me qëllim të investimeve të brendshme në prodhim, • Ndërprerjet e pagesës së tatimit apo jo tatimi, • Investimet ndihmëse në infrastrukturën fizike.
E dyta: 1980 deri te mesi i 1990	Gjatë fazës së dytë fokusi lëvizti më përpara: • Mbajtja (retencion) dhe rritja e bizneseve lokale ekzistuese • Ende theksi në tërheqjen e investimeve të brendshme, por zakonisht kjo ishte bërë duke u targetuar më shumë kah sektorët specifike ose fusha të caktuara gjeografike.	Që të arrihet kjo qytetet ofruan: • Pagesa direkte të biznesit individuale, • Inkubatorët e biznesit/hapësirat punuese për biznes, • Këshillime dhe trajnime për NVM-të • Përkrahja teknike apo Përkrahja e bizneseve në themelimin • Investime në infrastrukturë fizike dhe infrastrukturë soft
E treta: Fundi i 1990 –dhe ende vazhdon	Në këtë fazë fokusi kaloi nga transferimet direkte financiare për firmat individuale në krijimin e mjedisit të brendshëm biznesore më të favorshëm. Pra, fokusi më tepër drejtohet në: • Investimet në Infrastrukturën soft • Partnershipi publik/privat-PPP • Rrjetëzimi dhe fuqizimi i investimeve të sektorit privat për të mirën e sektorit publik • Tërheqja e investimeve të brendshme më të targetuara kah shtimi i përparësive konkurruese të fushave apo zonave lokale	Që të arrihet kjo qytetet përdorën: • Zhvillimin e një strategjie holistike (gjithëpërfshirëse) me qëllim të rritjes së firmave apo ndërmarrjeve lokale, • Ofrimi i një klime investuese konkurruese lokale, • Përkrahja apo inkurajimi i rrjetëzimit dhe bashkëpunimit, • Inkurajimi i zhvillimit të klustereve biznesore, • Inkurajimi i zhvillimit të resurseve humane dhe arsimimi i mëtejshëm i tyre, • Targetimi i afërt i investimeve të brendshme në përkrahje të rritjes grupore apo klustereve, • Përkrahja e përmirësimit të kualitetit të jetës


Sipas Michael Porter, “Strategjia nuk është një çështje e rastësishme por është një proces i qëllimshëm. Intuita është e gjallë dhe e mirë, por njerëzit kanë një kontroll mbi fatin e tyre. Dhe së fundit, ju mund të përmirësoni shanset tuaja për të bërë gjykime më të mira”. Intuita dhe Strategjia kanë të bëjnë me atë se gjithnjë duhet shikuar se ku është Strategjia. Duhet të jeni kreativ për të dizajnuar strategjinë përtej një planifikimi strategjik formal, dhe duhet të jeni inovativ duke mos u mbyllur në mendjet tuaja strategjike brilante si dhe duke qenë të vetëdijshëm për çfarë ju rrethon “

Sipas James Brian Quinn “Strategjia është si një lumë, vazhdimisht në fluks dhe rrjedhje, me degët e ndryshme të tij të cilat kontribuojnë në forcën e lumit. Megjithatë, është e vështirë të zbulohen rrymat e rëndësishme në një moment të caktuar”.


4.3. Strategjia dhe menaxhimi strategjik

Strategjitë nuk ekzistojnë për vetvete dhe nuk caktohen arbitrarisht. Ato janë mjete për arritjen e objektivave të marketingut dhe objektivave të përgjithshme të ndërmarrjes, kurse vet objektivat janë rezultat i vizionit dhe misionit të ndërmarrjes të përpiluara pas një procesi paraprak të ekzaminimit të ambientit të jashtëm dhe të brendshëm të ndërmarrjes.

Autorë të ndryshëm kanë mendime të ndryshme mbi hapat dhe etapat që e përbëjnë procesin e menaxhimit strategjik. Të gjithë pajtohen se formulimi, implementimi dhe vlerësimi i strategjive realizohen pasi të jenë përcaktuar objektivat afatgjatë të ndërmarrjes. Mirëpo papajtueshmëria qëndron në atë se a duhet të caktohet vizioni dhe misioni i ndërmarrjes para apo pasi të bëhet ekzaminimi i ambientit të jashtëm dhe të brendshëm.



Sidoqoftë, është gjerësisht e pranueshme (David, 2002; Kotler & Keller, 2006) se modeli më gjithëpërfshirës i procesit të menaxhimit strategjik është modeli i prezantuar si më poshtë:



Varësisht nga këndvështrimi, edhe strategjia merr kuptime të ndryshme. Ekzistojnë pesë definicione (5 P-të) kryesore dhe të ndërlidhura për strategjinë: plan (plan), ploy (manovër), pattern (model), position (pozicion) dhe perspective (perspektivë).

Strategjia si plan: - është formë e vetëdijshme/qëllimshme e rrugës së veprimeve e krijuar para ndodhjes së ngjarjeve. Kjo mund të jetë strategji e përgjithshme apo specifike. Nëse është specifike edhe mund të

Strategjia si manovër: - është e tillë nëse strategjia përdoret si manovër për të mashtruar kundërshtarin. Nëse një ndërmarrje kërcënohet se do të liroj çmimet për të demoralizuar hyrësit e rinj në tregun e saj. Kërcënimi për të ulur çmimet është rrugë e vetëdijshme/ qëllimshme e veprimit dhe jo ndonjë plan i vërtetë për të vepruar ashtu.

Strategjia si model: - Kjo është kur ne e vërejmë, pas ngjarjes, se një ndërmarrje ka vepruar në mënyrë të njëjtë gjatë gjithë kohës. Pra, qoftë me vetëdije apo jo, ndërmarrja vazhdimisht ka vepruar në mënyrë të njëjtë, ashtuqë mund të thuhet se kjo ndërmarrje ka ndjekur një strategji të veçantë, sipas në modeli të caktuar.

Strategjia si pozicion: - pozicionimi i ndërmarrjes në mënyrë që të arrijë apo mbajë një përparësi të qëndrueshme konkurruese. Dihet se shumica e ndërmarrjeve përpiqen të shmangin konkurrencën e drejtpërdrejtë. Çka ata përpiqen të arrijnë është një pozicion ku konkurrentët e tyre nuk mundën apo nuk duan t'i sfidojnë ata. Në këtë kuptim, strategjia mund të shihet si një lojë, ku grupe të lojtarëve mundohen të izolojnë lojtarët oponentë, duke zënë pozicion më të lartë. Për më tepër kjo strategji do të shpjegohet më poshtë (pjesa e Teorisë së Lojërave).

Strategjia si perspektivë: - ky definicion e sheh strategjinë si një koncept disi abstrakt që ekziston kryesisht në mendjet e njerëzve. Për anëtarët e një ndërmarrje, detajet e vërteta të strategjisë, si të tilla, janë jo-relevante. Ajo që është e rëndësishme është se secili anëtar i organizatës ndanë pikëpamje të përbashkëta të qëllimit dhe drejtimit, dhe pa marrë parasysh nëse njerëzit janë të vetëdijshëm për këtë apo jo, këto pikëpamje i përcaktojnë vendimet dhe veprimet e tyre. Rrjedhimisht, pa pasur nevojë për plane të detajizuara, përmes këtij mirëkuptimi, organizata vazhdimisht e ndjek një strategji. (Mintzberg, 1998)


Së këndejmi përmes metodës kërkimore është mësuar se gjendja në Kosovë është si vijon sa i përket çështjes nëse ndërmarrjet në tregjet në shqyrtim a kanë strategji të miratuara.

TABELA. 3 ORGANIZATA KA STRATEGJI TË MIRATUAR

	%	Përfundimet
PO	82.20	Ndërmarrjet e anketuara kanë strategji konkrete të miratuara në vlerën 82.2%
JO	17.36	Ndërmarrjet e anketuara nuk kanë strategji konkrete të miratuara në vlerën 17.36%
Nuk e di	0.44	Nga të anketuarit, 0.44% nuk kanë njohuri nëse ka apo jo strategji të miratuara
Totali	100	Mund të përfundojmë se ndërmarrjet e anketuara në masën më të madhe veprojnë sipas një plani strategjik!

Burimi- Anketimi

GRAFIKU 2, ORGANIZATA KA STRATEGJI TË MIRATUAR



Burimi: Tabela 3

TABELA 4. STRATEGJIA MË E RËNDËSISHME E BIZNESIT

Strategjia e biznesit	%
Përmirësimi i kualitetit të produkteve dhe shërbimeve,	47.7
Marketingu dhe aktiviteti reklamues	14.8
Avancimi i mjeteve kryesore nga aspekti teknologjik	10.9
Ngrija e aftësive të punëtorëve për të bërë punë më të mirë	7.0
Zvogëlimi i shpenzimeve	19.5
Total	100.0

Burimi: BSCK SME Survey 2011

Sipas rezultateve nga tabela vërehet se, strategjia më e rëndësishme për bizneset në tregjet në shqyrtim është përmirësimi i cilësisë së produkteve dhe shërbimeve. Të dhënat e anketës tregojnë se 47.7 % e ndërmarrjeve gjykojnë se përmirësimi i cilësisë së mallrave dhe shërbimeve është strategjia kryesore e tyre. 19.5 për qind e tyre kanë synim uljen e shpenzimeve, 14.8 përmirësimin e marketingut dhe aktiviteteve promovuese, 10.9 % avancimin e teknologjisë dhe pajisjeve, si dhe 7.0 % rritjen e aftësisë së punëtorëve për performancë më të mirë. Rritja e aftësive të punonjësve për performancë më të mirë nuk duket që është strategji me prioritet të rëndësishëm të ndërmarrjeve, e cila ri konfirmon rezultatet e investimit të ulët të ndërmarrjeve në trajnimin dhe performancën e stafit në krahasim me kategoritë e tjera të diskutuara më sipër.

TABELA 5. RËNDËSIA E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE NË STRATEGJITË E BIZNESIT TË NVM-VE

Objektivat strategjike më të rëndësishme në kompaninë tuaj (1-shumë i rëndësishëm deri në 5-jo i rëndësishëm)	Mesatarja
Cilësia e produktit	1.7
Imazhi	1.9
Kualiteti i Shërbimeve	1.8

Pjesa e tregut	2.3
Pozicioni në industri	3.4
Penetrimi në tregjet ndërkombëtare	4.6

Burimi: BSCK SME Survey 2011

Në aspektin e strategjive dhe investimeve për të ardhmen, Kërkimi ka treguar se ndërmarrejt e marra në shqyrtim nuk janë inovative në gjetjen e tregjeve të reja dhe mundësive për biznesin. Këto ndërmarreje ekonomike, më së shumti janë duke planifikuar të vazhdojnë punën në të njëjtat fusha si biznesi i tyre aktual. Prioritetet në objektivat strategjike të dhëna nga kompanitë janë si më poshtë: Produkte dhe shërbime me cilësi me mesatare 1.8, imazhi i produktit 1.9, segmentimi i tregut 2.3, pozicioni në industrinë 3.4 dhe e fundit, penetrimi ndërkombëtar i tregut me mesatare 4.6.

TABELA 6. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

	%	Përfundimet
Rritja e cilësisë së shërbimit	5.93	Duke e ditur se ndërmarret mendojnë se preferohen nga
Përmirësimi i imazhit të kompanisë	21.54	konsumatorët e tyre për shkak të imazhit të tyre në treg, vetëm
Rritja e pjesës së tregut	29.01	rreth 22% e tyre mendojnë ta përmirësojnë atë, dhe synojnë ta
Nivel i lartë shërbimi	30.77	rrisin pjesëmarrjen në treg 29%, ndërsa Ndërmarret mendojnë
Përmirësimi i pozicionit të kompanisë në industri	12.75	se kanë nevojë t'i përmirësojnë shërbimet në nivel më të lartë në
Totali	100	vlërën rreth 31%!

Burimi: Anketimi

4.4 Menaxhimi dhe menaxhimi strategjik

Menaxhimi, është hapi i parë i realizimit të MS. Termi “menaxhim” ka shume dimensione dhe përkufizime, te cilat variojne me shume sesa përshkrimi qe u behet funksioneve te tij. Brech e përcakton menaxhimin si “Një proces social qe ka përgjegjësi për planifikimin dhe rregullimin efektiv dhe ekonomik te operacioneve te një organizate me qëllim që të arrihet një objektivi apo një detyre e dhënë.” (Brech E. F. 2012) Një përgjegjësi e tille përfshinë:

Vlerësimin e gjendjes dhe marrjen e vendimeve për përcaktimin e planeve, për përdorimin e te dhënave për kontrollin e performancës dhe te nivelit te progresit kundrejt planeve.

Udhëheqjen, integrimin, motivimin dhe mbikëqyrjen e personelit te organizatës, i cili kryen operacionet e saj” (Brech. E. F. 2012)

Sipas P. Drucker-it, menaxhimi ka tri detyra kryesore :

Te realizoje qëllimin dhe misionin specifik të organizatës.

Ta beje punën produktive dhe punëtorin ta arrije atë.

Te menaxhoje impaktet dhe përgjegjësitë sociale (P. Drucker, 1977)

F. Luthanas dhe R. Hodgetts japin një përkufizim me te thjeshte te menaxhimit: “Menaxhimi është procesi i përcaktimit te objektiveve dhe e koordinimit te përpjekjeve te punonjësve për ti arritur ato” (Luthanas & Hodgetts, 1992)

Sot në botë ka mjaft autore dhe studiues te menaxhimit dhe secili prej tyre jep një definicion te ndryshëm nga te tjerët. R. Heller një autor i njohur ne këtë fushe, pohon se çdo përpjekje për te dhëne një përgjigje përfundimtare për këtë çështje është e destinuar te mos këtë sukses. Ai thekson se “çdo definicion i menaxhimit është i drejte, sepse secili prej tyre plotëson diçka ne këtë fushe amorfe dhe ne ndryshim” (R. Heller, 1972),” por, ne vetvete, ato janë shume te ngushta apo te paqarta për te dhëne një përkufizim adekuat te menaxhimit” (L. Mullins, 1999).

“Menaxhimi është procesi i arrijtes se objektiveve organizative duke punuar me dhe nëpërmjet njerëzve dhe burimeve të tjera organizative ” (Certo & Certo, 2006)

Ky konceptim i sotëm tregon se menaxhimi ka tre karakteristika kryesore :

Është një proces që përfshin një seri aktiviteteve te vazhdueshme dhe te ndërlydhura,

Përqendrohet në arrijten e objektiveve organizative, dhe

Synon arrijten e këtyre objektiveve duke punuar me dhe nëpërmjet njerëzve e burimeve te tjera te organizatës.

Krijimi i kanaleve të përshtatshme të komunikimit për të lehtësuar komunikimin në organizatë është kritik për suksesin e ndryshimit, sepse ndihmon reduktimin e rezistencës, lehtëson shkëmbimin e informacionit dhe mbështet marrëdhëniet mes punonjësve (ELTRUN 2005).

Sipas Luecke (2003) komunikimi është një mjet efektiv për motivimin e punonjësve, kapërcimin e rezistencës, për përgatitjen e punonjësve për avantazhet e disavantazhet e ndryshimit dhe për t'i dhënë atyre një rol në proces. Allen J., Jimmerson N.L., Bordia P., Irmer B.E., (2007) ndërmorën dy studime për të vlerësuar rolin që luajnë burimet e informacionit në trajtimin e pasigurisë së punonjësve që lidhet me ndryshimin. Studimi i parë ishte me karakter cilësor dhe tregon rezultatet e 25 intervistave të realizuara me punonjës të organizatave të ndryshme. Nga studimi rezultoi se burimi i komunikimit luante rol të rëndësishëm në aftësinë e punonjësve për të reduktuar pasigurinë. Duke vlerësuar tipin e informacionit të marrë nga burime të ndryshme, rezultoi se komunikimi nga ana e menaxherëve të lartë ishte i përqendruar mbi çështjet **strategjike** si arsyeja e ndryshimit apo drejtimi i organizatës në të ardhmen. Por gjatë fazave të ndryshme të ndryshimit ato përdorin më tepër informacionin nga supervizorët që lidhet me punën e tyre.

Studimi i dytë u realizua me punonjësit e një departamenti qeveritar. Punonjësit që kishin marrë komunikim cilësor mbi ndryshimin treguan qëndrime më pozitive ndaj ndryshimit. Komunikimi cilësor mbi ndryshimin kishte një marrëdhënie pozitive me hapjen e punonjësve ndaj ndryshimit. Është cilësia e informacionit të marrë nga punonjësit më tepër sesa thjesht siguri i informacionit e rëndësishme në influencimin e hapjes ndaj ndryshimit.

Mungesa e komunikimit apo mesazhet e papërshtatshme, keqkuptimi i qëllimeve apo procesit të ndryshimit çojnë në mungesë të përkushtimit ndaj ndryshimit (Gill, 2003). Mungesa e komunikimit me punonjësit gjatë ndryshimeve të mëdha organizative është gabimi më i keq që mund të bëjë një organizatë. Ata japin tre arsye pse komunikimi dështon:

Organizatave e fillojnë komunikimin tepër vonë. Zakonisht organizatat nuk komunikojnë gjatë kohës që planifikojnë ndryshimin, por e bëjnë një gjë të tillë kur plani është përcaktuar. Vonesat në komunikim rrisin rezistencën e punonjësve.

Organizatave përdorin teknologjinë për të komunikuar. Kur ndryshimi është i madh punonjësit parapëlqejnë bisedat ballë për ballë me menaxherin në vend të prezantimeve formale, informacionit në ueb-site, etj. Komunikimi ballë për ballë konsiderohet si kanali më i përdorur, më i besuar, më efektiv dhe më i shpejtë për transmetimin e mesazhit në kompanitë e mëdha.

Organizatave nuk flasin rreth rezultateve. Në fillimet e komunikimit zakonisht flitet rreth vlerave, metodologjisë që do përdoret, rëndësisë së përkrahjes së ndryshimit, etj. Por punonjësit do humbin besimin tek liderët e tyre kur ata e shohin se komunikimi është 'bosh'.

Në një studim të Gilley A., Gilley J.Ë., McMillan H.S., (2009, 75-94) rezultoi se liderët që i kushtojnë rëndësi motivimit dhe komunikimit kanë më tepër mundësi për të zbatuar me sukses ndryshimin. Liderët duhet t'i ushtrorin këto aftësi (motivimi dhe komunikimi) dhe t'i përkthejnë ato në sjellje të dukshme. Nëse liderët nuk i kushtojnë rëndësinë e duhur këtyre aftësive, atëherë organizatat e tyre do jenë një numër më tepër në statistikat e dështimit.

Udhëheqja e ndryshimit kërkon përdorimin e teknikave të ndryshme të komunikimit për të shpërndarë mesazhin e duhur, për të kërkuar feedback-un, krijuar gatishmërinë për ndryshim bashkë me një sens urgjence, dhe motivuar marrësit për të vepruar (Gilley A., Gilley J.Ë., McMillan H.S., 2009: 79).


Së këndejmi përmes hulumtimit në teren gjendja qëndron si vijon sa i përket komunikimit të strategjisë nga top-menaxhmenti tek vartësit.

TABELA 7. KOMUNIKIMI I STRATEGJISË TEK PUNONJËSIT/VARTËSIT ËSHTË BËRË NË FORMË

	%	Përfundimet
Me shkrim	21.63	Pjesa më e madhe e Ndërmarrjeve, 77% e tyre e komunikojnë strategjinë e tek punonjësit në formë verbale. 2 anketues nuk janë përgjigjur.
Me gojë	77.26	
Tjetër	1.10	
Totali	100	

Burimi - Anketimi

GRAFIKU 3. KOMUNIKIMI I STRATEGJISË TEK PUNONJËSIT



Burimi - Tabela 7

TABELA 8. FAKTORËT QË LIDHEN ME SUKSESIN E STRATEGJISË JANË:

	%	Përfundimet
Menaxhim kurajoz - ambicioz	54.95	Nëse shikohen të dhënat nga tabela mund të themi se të rëndësishme pothuajse të barabartë në funksion të suksesit të strategjisë qëndrojnë si Menaxhimi ambicioz ashtu edhe Qëndrimi racional!
Qëndrimi racional	45.05	
Totali	100	

Burimi - Anketimi

Pa një strategji ndryshimi, vizioni mbetet një ëndërr (Gill 2003). Hartimi i një vizioni drejton dhe nxit anëtarët e organizatës gjatë ndryshimit. Por organizata ka nevojë edhe për një plan që të tregojë se çfarë të bëjë, si dhe kur (Luecke 2003). Organizatat e suksesshme krijojnë vizion dhe strategji të qartë, ndërsa ato jo të suksesshme kanë vetëm plane të detajuara e buxhete që nuk janë të mjaftueshme dhe vizione jo të 'ndjeshme' ndaj asaj që po ndodh përreth. Disa karakteristika të një plani të mirë zbatimi janë (Jick 1993, cituar tek Luecke 2003):


është i thjeshtë
 është krijuar nga njerëzit në të gjitha nivelet e prekura
 është i strukturuar në pjesë të arritshme
 specifikon rolet dhe përgjegjësitë
 është fleksibil

TABELA 9. A E STUDIONI MJEDISIN E BRENDSHËM DHE TË JASHTËM TË ORGANIZATËS TUAJ PËRPARA SE TË NDËRMERRNI NDRYSHIME STRATEGJIKE?

	%	Përfundimet
Po	81.32	Shumica absolute e Ndërmarrjeve bëjnë studim të ambientit të jashtëm dhe të brendshëm kur është fjala për ndërhyrje në Strategjitë e tyre!
Jo	17.80	
Nuk e di	0.88	
Totali	100	

Burimi - Anketimi

GRAFIK 4. A E STUDIONI MJEDISIN E BRENDSHËM DHE TË JASHTËM TË ORGANIZATËS TUAJ PËRPARA SE TË NDËRMERRNI NDRYSHIME STRATEGJIKE?



Burimi - Tabela 9

Nga tabela mund të mësohet më lehtë gjendja faktike e kompanive të cilat veprojnë sipas Menaxhimit Strategjik, dhe të dhënat e ofruara demonstrojnë se gjendja nuk është stadin e vet më të mirë të mundshëm, mirëpo që elementet kyç të mirëfunksionimit të ndërmarrjeve tona të intervistuar, hulumtuara, tregojnë se janë në rrugë të mbarë të realizimit me përpikëri, si kur është fjala tek komunikimi brenda ndërmarrjes, ndërmarrjes me klient dhe anasjelltas, ashtu në fushat e rekrutimit të stafit, stimulimit e edhe në fushat më pikante si ajo e miratimit të strategjive nga kompetentet dhe njohësit e ndërmarrjes, studimi i ambientit të jashtëm dhe atij të brendshëm, azhurnimit të planeve strategjike de financiare.

TABELA 10 VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I KOMPANIVE MBI KOMPONENTËT SPECIFIKE KORELATIVE ME MENAXHIMIN STRATEGJIK (1- PAK I RËNDSISHEM/APLIKATIV DERI NË 5- SHUMË I RËNDSHËM/APLIKATIV)

	1	2	3	4	5
	%	%	%	%	%
Përgjegjësitë për udhëheqje dhe vendim-marrje dihen dhe distribuimi i tyre bëhet në mënyre adekuate.	0	0	0	0.66	99.3
Pjesëtarët e stafit janë të gatshëm ta marrin përsipër udhëheqjen.	0	0	3.96	53.8	42.2

Njerëzit/ punonjësit janë të gatshëm që personave në poste të larta t'u komunikojnë ide të reja.	0.44	0.88	80.2	18.5	0
Udhëheqja është efektive në sigurimin dhe ruajtjen e resurseve.	0	0	0	47	53
Udhëheqja praktikon menaxhim participator, kurse bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti kanë bashkëpunim të mirë.	0	0	0	0	100
Udhëheqja është fleksibile dhe i mirëpret ndryshimet.	0	0	73.4	0	26.6
Organizata ka plan të detajuar financiar.	0	17.8	0	0	82.2
Strategjia u është e njohur bordit të drejtorëve, menaxherëve të lartë dhe stafit tjetër.	0	0	16.7	0	83.3
Strategjia në përgjithësi pranohet dhe mbështetet nga stafi i organizatës.	0	0	19.6	2.64	77.8
Strategjia përdoret si ndihmesë për marrjen e vendimeve.	0	0	3.3	34.3	62.4
Struktura e organizatës përkrah qëllimet dhe misionin e saj.	0	0	3.62	3.17	93.2
Rolet brenda organizatës janë të definuar mirë.	0	1.98	9.01	1.76	87.3
Roli i organizatës definohet qartë me misionin e saj.	0	0	0	0	100
Fushat e specializimit janë të qarta.	0	0	0	0	100
Organizata ndërmer planifikim përkatës financiar për ta përkrahur performancën e organizatës	0.22	0	21.1	78.7	0
Planet buxhetore janë të përshtatshme për kohën e dhënë	0	0	2.86	6.59	90.5
Planet buxhetore azhurnohen, duke ndjekur arritjen e informacioneve	0	0	0	7.91	92.1
Planifikimi, politika dhe zhvillimi i procedurave, paraqiten në çdo nivel të organizatës, nga bordi udhëheqës deri të departamentet dhe projektet individuale	0	0	0	77.4	22.6
Procesi i planifikimit i kontribuon orientimit strategjik të organizatës.	0	0	0	78.2	21.8
Planet janë të qarta, dhe pjesëtarëve të organizatës u ofrojnë orientim adekuat.	0	0	0	0	100
Planifikimi është pjesë e kulturës së organizatës.	0	0	0	13	87
Pjesëtarët e stafit e ndjejnë se janë të kyçur në planifikim.	15.2	12.7	21.5	34.7	15.8
Kemi një kulturë organizative që vlerëson inovacionin	21.1	18.7	12.7	20.2	27.3

5. Konkluzione/ Rekomandime

Rezultatet e këtij studimi çojnë në konkluzionin se, në qoftë se menaxherët synojnë për të krijuar pasuri për firmat e tyre, ata duhet të integrojnë në mënyrë efektive veprimet strategjike. Megjithatë, procesi i integritimit përfshin një tërësi çështjesh dhe problemesh. Firmat përballen me sfidat e ndryshimit, fleksibilitetin strategjik, dhe çështjet që lidhen me procesin e implementimit. Prezantimi dhe Analiza e rezultateve të të dhënave në këtë studim përfshin përgjigjet e pjesëmarrjes së menaxherëve/pronarëve për pyetjet nga pyetësi të përmendura gjatë punimit. Një nga qëllimet tona ishte të hetojmë faktorët e shkallës së besueshmërisë (scales) duke përfshirë të gjitha shkallët e gjashtë fushave në një analizë faktoriale dhe analizën e regresionit për nivelin e fitimit dhe qarkullimin e përgjithshëm. Tabelat që rezultuan nga analiza e të dhënave tregojnë se të dhënat e grumbulluara nga pyetësori zbulojnë se gjashtë fushat për integrimin e veprimeve sipërmarrëse dhe strategjike ishin të dallueshme nga njëra-tjetra.

Statistikat përshkruese të cilat i kemi përdorur varësisht nga çështja e cila duhej analizuar, tregojnë një renditje e cila varet nga shkalla e shprehur për përgjigjet e menaxherëve/pronarëve.

Kjo shkallë është e shprehura varësisht nga matja e përgjigjeve të tyre. Në disa raste është shprehur me 1, 0 (pohim apo mohim, në disa raste me 1, 2, 3 (më mirë, pa ndryshime dhe më keq) apo rastet nga 1-5 (nuk pajtohem plotësisht, nuk pajtohem, neutral, pajtohem, pajtohem plotësisht). Prandaj, ka pasur konsensus të përgjithshëm në mesin e menaxherëve/pronarëve, që tregon se inovacionet, rrjetëzimi, ndërkombëtarizimi, të mësuarit organizativ, ekipet e menaxhimit të lartë dhe orientimi kah rritja janë kritike për procesin e integritimit në mënyrë që firmat të krijojnë pasuri, përkatësisht të rrisin nivelin e fitimit dhe qarkullimin e përgjithshëm.

Strategjia dhe faktorët e menaxhimit strategjik të Biznesit

Për sa i përket nivelit të signifkancës të faktorëve të menaxhimit strategjik të cilët ndikojnë në nivelin e fitimit të firmave, rezultatet janë relativisht inkurajuese pasi “strategjia e penetrimit të tregut” dhe “strategjia e ndryshimeve organizative të menaxhimit në marketing” treguan signifkancë të kënaqshme, përkatësisht 0.006 dhe 0.051 (në fakt mundësia e gabimit është 0.6 % dhe 5.1%).

Ndërsa analiza e regresionit të faktorëve të menaxhimit strategjik në qarkullimin e përgjithshëm të ndërmarrjeve në vitin 2012 tregoi një signifkancë relative pasi që vetëm “strategjia e penetrimit të tregut” tregoi signifkancë të kënaqshme, përkatësisht 0.009 dhe “ndryshimet organizative në marketing” me signifkancë të pakënaqshme, përkatësisht 0.118 (mundësia e gabimit është 11.8%). Kjo e dhënë do të thotë që vetëm këta dy faktorë kanë ndikim në nivelin e qarkullimit të ndërmarrjeve, rrjedhimisht edhe në thellimin e zhvillimit ekonomik të vendeve.

Si përmbledhje të rekomandimeve mund të themi se menaxherët/pronarët duhet të miratojnë teknikat e sugjeruara për trajtimin e fleksibilitetit strategjik. Pra duhet të ‘krijojnë’ një leadership strategjik të ushtruar dhe sprovuar, të ndërtojnë në mënyrë dinamike kompetencat themelore të punonjësve, të përqendrohen në zhvillimin e kapitalit njerëzor, të shfrytëzojnë në mënyrë efektive teknologjitë e reja, të angazhohen në strategjitë e vlefshme dhe zhvillimin e një strukture dhe kulture të re organizative. Këto teknika apo hapa janë mënyra praktike për të siguruar fleksibilitet të strategjive të tyre, si dhe për parashtruar kërkesat substanciale për menaxhimin e ndryshimeve të hasura organizative.

Bibliografia

- Alas R., (2007), 'The impact of employee participation on job satisfaction during change process', *Problems and Perspectives in Management*, vol 5, no 4,
- Alexander, L. D. (1991). Strategy implementation: Nature of the problem. *International Review of Strategic Management*, 1, 73-113.
- Arthur A. Thompson and A.J. Strickland "Strategic Management: Concepts and Cases
BSCK Study Research Report 2011
- Burnes B., (2009), *Managing Change: a strategic approach to organisational dynamics*, FT Prentice Hall, botimi i pestë. Central Bank of Kosovo – CBK Annual Report 2011
- David, R. Fred, 2002. *Strategic Management – Concepts and Cases*. 9th ed. USA: Prentice Hal; Denise
- Lindsey Wells, *Strategic Management for Senior Leaders*, Jefferson Davis Highway, Virginia, 2000
- Dress, G.G., Lumpkin, G.T., & Govin, J.G. (1997). Entrepreneurial strategy making and firm performance: Test of contingency and configurational models. *Strategic Management Journal*.
- Drucker, P.: *The Practice of Management*, Harper & Row, New York, 1954,
- Ginter dhe të tjerë, 2002. *Strategic Management of Health Care Organizations*. 4th ed. New Jersey, USA: Blackwell Publishing, faqe.213
- Gundry, L. K., & Welsch, H. P. (1997). The ambitious entrepreneur: Attributes of firms exhibiting high-growth strategies. In P. D. Reynolds, W. D. Bygrave, N. M. Carter, P. Davidsson, W. G. Gartner, C. M. Mason, & P. P. McDougall, (Eds.), *Frontiers of entrepreneurship research*. Babson Park, MA: Babson College: 68-79
- Hargadon, A., & Sutton, R. I. (2000). Building an innovation factory. *Harvard Business Review*, 3, 157-166.
- Hill, C. W. L (2007), *International Business: Competing in the Global Marketplace*, 6th ed., New York: McGraw-Hill
<http://www.informacioni.com/20-kendveshtrime-per-biznesin-nga-investitoret-me-te-suksesshem-ne-histori/> Jeffrey
- Bracker, (2004), The historical development of the strategic management concept, Georgia State University. John A. Pearce II & Richard B. Robinson, "Strategic Management" – McGraw-Hill Irwin 2003.
- Krasniqi BESNIK " Entrepreneurship and Small Business Development in Kosova, Nova Science Publisher, New York, 2012.
- Luecke R., (2003), *Managing change and transition*, Harvard Business School Press, Boston, MA.
- Porter, E. Michael: From competitive advantage to corporate strategy, *The McKinsey Quarterly*, 1987, faqe 35.
- Porter, E. Michael: What is Strategy, *Harvard Business Review*, Boston, USA, 2001
- Thompson, A. J. Strickland: "Strategic Management", Nine edition, IRVIN, N.York, 1996
- Vaselika Kume, 2010, *Menaxhimi Strategjik, teori, koncepte, zbatime*, bot.III, Pegi, Tiranë
- West, G. P., & Meyer, G. D. 1998. To agree or not to agree: Consensus and performance in new ventures. *Journal of Business Venturing*, 13: 395–422
- West, G. P., III, & Meyer, G. D. (1998). To agree or not to agree? Consensus and performance in new ventures. *Journal of Business Venturing*, 13, 395-422.

EVIDENCE OF GENDER DISCRIMINATION IN WAGES EARNED IN ALBANIA THROUGH THE USE OF LFS DATA

PHD. ENTON DURO

Lecturer at University of Tirana, Faculty of Economy Department of Economics, email entonduro@feut.edu.al

PHD. MERITA CANI

Lecturer at "Marin Barleti" University, Department of Finance, meri.cani@yahoo.com

ABSTRACT

Discrimination is not only a labor market phenomenon. It could be detected in various levels of society development. World Bank's engagement in gender discrimination issues has made it clear to understand the ranking of this problem as part of the Millennium Development Goals. Albania is also a country where this phenomenon exists. By using LFS data for 2013, we can conclude that female employees are paid less than males, even when the endowment factors are the same. These conclusions have been made possible through the use of Oaxaca Blinder method of decomposition. Referring to the method of estimation, the results for Albania indicate that females are more endowed than males, even though the average wages of females as a group are 41,395.85 (LEK) less than males.

Key words: Oaxaca Blinder method, LFS data. Endowment.

1. Gender Discrimination as an economic inefficiency

Labor market is the fundamental issue in macroeconomic analysis. Overall economic environment seems to be conditioned upon efficiency missing in labor market. One of the influencing factors is discrimination and this is not a novelty. In particular, gender discrimination makes no efficient allocation of skills and discourages human capital investment, good promises for the lack of growth and development (Kassen, 1999). Research findings indicate that women generally are paid less than men, independently from the method of analysis, market and individual characteristics, working conditions and others (Hersch, 2006). These findings refer to developed countries of Europe. Rice (1999) concludes that, with the exception of Denmark, women earnings depend heavily from their social status, i.e. married women face challenges in pursuing higher education and consequently, earning higher wages.

The situation is more pessimistic in developing countries. Gender discrimination there is more widespread. In contrast with developed countries, girls get less education than boys, women realize fewer investments in wealth, women's legal rights in economic aspects of life are weaker and they possess less political power (Dollar & Gatti, 1999).

According to Ekonomi et al (2015) women earn 17,4% less than man for 2011 in Albania. The authors find that woman are mainly employed in sectors like education, social service, health, most important in social and economic environment, but are less paid (horizontal discrimination). Also, in public sector women represent larger number of office expert employed but occupy fewer leading position which earn higher payment (vertical discrimination).

World Bank's engagement in gender discrimination is straightforward. Promoting gender equality and empowering women are ranked among the Millennium Development Goals. The use of World Bank data sources brings evidence to a pessimist scene. Only 2 countries out of 130, have achieved gender equality at all levels of education. In 2011, only 16.2% of places in ministerial level positions were taken up by women and 40% of non-agricultural income from wages was held by women.

2. Blinder Oaxaca, decomposition method

Blinder (1973) Oaxaca (1973) offers a method to distinguish the differences derived by endowment, discrimination and by interaction of both. Let assume that:

$$\ln(w) = b_0 + \sum X_i b_i + \varepsilon_i \quad \varepsilon_i \text{ i.i.d } (0, \sigma^2)$$

$X_i \rightarrow$ Independent variables vector such as education, experience, job time, etc. This function could be estimated by gender as (f) female and (m) male:

$$\ln(w^m) = b_0^m + \sum X_i^m b_i^m + \varepsilon_i^m \tag{1}$$

$$\ln(w^f) = b_0^f + \sum X_i^f b_i^f + \varepsilon_i^f \tag{2}$$

If we are interested in average differences, we can solve it by subtracting equation (2) from (1):

$$\ln(w^m) - \ln(w^f) = (b_0^m - b_0^f) + \left(\sum \bar{X}_i^m b_i^m - \sum \bar{X}_i^f b_i^f \right) \tag{3}$$

By transformations:

$$\Delta \ln w = \Delta b_0 + \sum \Delta b_i \bar{X}_i^f + \sum \Delta \bar{X}_i b_i^f + \sum \Delta b_i \Delta \bar{X}_i \tag{4}$$

$\sum \Delta b_i \bar{X}_i^f \rightarrow$ This term is "unexplained" in differences. The authors define it as a difference due to discrimination.

$\sum \Delta \bar{X}_i b_i^f \rightarrow$ Is partly explained by differences in endowment. This term implies the effect of differences in observable factors such as education, experience and others that could have an objective impact on wages. Particular attention should be paid to such interpretation especially when referring to the aforesaid arguments supported by our literature sources.

$\sum \Delta b_i \Delta \bar{X}_i \rightarrow$ Interaction term between the previous two terms.

Latter in our analysis, we shall proceed with estimates of these terms.

3. Coded variable of the research using LFS 2013 in Albania

This research is conducted by using LFS¹ data for the year 2013 based on INSTAT². There are different categories of variables included in them, but only a few were selected based upon the data quality. After the exclusion of unacceptable responses and the control for possible outliers we have come up with 4721 cases with the respective variables.

Wage – The survey does not offer sufficiently available data for wages. As a useful proxy, answers to the question “How much is your usual NET payment or earning? (Q67)” have been used, corrected by the period when these earnings were earned, which was represented by the question “What period of time does this payment cover? (Q68)”. This question has four possible outcomes: 1=month; 2=15 days; 3=week; 4=daily. All payments or earnings are converted later on a monthly basis.

Education –for education responses to the question “Educational level (EDU3)” has been applied. The answers were classified into three major groups: 1=Primary; 2=Secondary; 3=Tertiary.

Civil status – There is a coded variable “MARSTAT” in LFS 2013, representing civil status of the respondent. In this research, we have been using a Dummy variable for married person (D_2). There is no clear assumption of this classification, conditioning future research.

Job time – wages earned are in relation with the type of job, full or part-time. We have used the category variable 1 for part time and 2 for full time. When answering this question, the respondent normally makes references to his current job, as opposed to the “usual payments or earnings”, which represent average, not current estimates. Anyway, an important factor to consider is that people usually tend to hide or understate the real figure of their salaries.

Age - It is expected to find a positive effect of age in wages due to higher experience over time, but also an opposite effect on productivity and consequently on wages. For the second effect, the **Age square**, which represents a downturn in wages, has been applied.

Sex- is presented by categorical variable, 1=male and 2=female.

4. Data analysis outcomes

The first test was to estimate differences in average wages by gender. As highlighted in table 1 in the Appendix, we have discovered the existence of a statistically significant difference of 41,395.85 (LEK). This test is an eye opener to other tests. Starting with OLS regression, a significant explanation of $\ln(\text{wage})$ is found by all the variables taken into consideration. The regression can explain 23.6% of the $\ln(\text{wage})$ variation and the parameters are statistically significant (p value is smaller than 0.05 in all cases). These interpretations are summed up in Table 2. Referring to the partial correlation between independent variables (Table 3), we did not find any higher values, assuming that multi-co-linearity is not a problem. Also, the test of Heteroscedasticity excludes the presence of them in the regression (table 4) and the residual analysis confirms the OLS assumptions (Table 5; 6)

In the later analysis, Oaxaca Blinder decomposition represents, in the first step, two distinct regressions by gender. For male, the regression can explain only 17.8% of the variance in $\ln(\text{wage})$ versus 38.5% of female. As noted in table 7, the Age and D_2 independent variable are not significant for the female group. These results prompt for other investigation in differences between the groups. Referring to Oaxaca Blinder decomposition significant differences are found in endowments, coefficient (discrimination) and interaction. The negative value of “endowment” should be considered as higher possession of production factors of female i.e., female are more educated than male. The “coefficient” term is positive meaning that discrimination is present in labor market and females are paid less than males when they have the same level of endowments.

5. Conclusion

It is now common knowledge and not a novelty the labor market discrimination is a widespread phenomenon in different societies. This occurrence is visible and present not only in developing countries, but also in developed societies. As a technique of estimating discrimination, Oaxaca Blinder Method is an appropriate procedure that decomposes the effects in three different subsets. This procedure has been applied in the case of Albania, using the LFS of year 2013 and the results fully confirm the presence of discrimination in the Albanian labor market. This conclusion is substantiated by the positive and significant values found in the “coefficient” term that represents differences in $\ln(\text{wage})$ due to discrimination. Based on the survey results, we assume that female employees in Albania are more endowed than their male counterparts. Anyway, we accept that further research might be required to further solidify this evidence/finding given the quality of LFS data.

References

Blinder, A. (1973). "Wage discrimination: Reduced form and structural estimates." *Journal of Human Resources* 8(4): 436–455.

Blau, F, and Kahn, L. (2000). "Gender Differences in Pay." *Journal of Economic Perspectives* 14(4): 75–99.

David, D. and Gatti, R.(1999), "Gender Inequality, Income, and Growth: Are Good Times Good for Women?" Working Paper No. 1, Policy Research Report on Gender and Development, World Bank

Hersch, J, (2006). Sex Discrimination in the Labor Market, *Foundations and Trends in Microeconomics* Vol. 2, No 4, pp 281-361

Klasen, S, (1999). "Does Gender Inequality Reduce Growth and Development? Evidence from Cross-Country Regressions", Working Paper No. 7, Policy Research Report on Gender and Development, World Bank

Oaxaca, R. (1973). "Male-female wages differentials in urban labor markets." *International Economic Review* 14(3): 693–709.

Rice, P. (1999). Gender Earnings Differentials: The European Experience, Working Paper, No. 8, Policy Research Report on Gender and Development, World Bank

Ekonomi, M. et al 2015, Gender Inequalities in Pay: An Albania case, Gender Alliance for Development Centre, SOROS http://www.millennia2015.org/files/files/Publications/Gender_Inequalities_Pay_1_.pdf date of access 28.03.2015

World Bank 2015, <http://www.worldbank.org/mdgs/gender.html> date of access 28.03.2015

APPENDIX

Table 1 Differences in mean between female and male

```

. label variable Wage "Wage"
. ttest Wage, by(Sex)
Two-sample t test with equal variances

```

Group	Obs	Mean	Std. Err.	Std. Dev.	[95% Conf. Interval]
1	2832	350825.7	4753.541	252967	341504.9 360146.4
2	1889	309429.8	3931.245	170862.2	301719.8 317139.8
combined	4721	334262.1	3269.663	224657	327852 340672.1
diff		41395.85	6647.267		28364.1 54427.6

```

diff = mean(1) - mean(2)
Ho: diff = 0
Ha: diff < 0
Pr(T < t) = 1.0000
degrees of freedom = 4719
Ha: diff != 0
Pr(|T| > |t|) = 0.0000
Ha: diff > 0
Pr(T > t) = 0.0000
t = 6.2275

```

Table 2 OLS of Ln_Wage

```

. regress ln_wage Sex Age Age_sq Edu Job D_2

```

Source	SS	df	MS	Number of obs =	4721
Model	217.847557	6	36.3079262	F(6, 4714) =	244.37
Residual	700.391399	4714	.148576877	Prob > F =	0.0000
Total	918.238956	4720	.194542152	R-squared =	0.2372
				Adj R-squared =	0.2363
				Root MSE =	.38546

ln_wage	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]
Sex	-.1779147	.0117754	-15.11	0.000	-.2009999 -.1548295
Age	.0170245	.003583	4.75	0.000	.0100002 .0240489
Age_sq	-.0001819	.0000417	-4.36	0.000	-.0002636 -.0001002
Edu	.2083003	.0075882	27.45	0.000	.1934239 .2231767
Job	.292431	.0176544	16.56	0.000	.2578201 .3270419
D_2	.0522714	.0155202	3.37	0.001	.0218446 .0826982
_cons	11.46975	.0736641	155.70	0.000	11.32534 11.61417

Table 3 Correlation diagnostic

```
. kdensity Resid
```

```
. correlate Sex Age Job Edu ln_wage
```

(obs=4721)

	Sex	Age	Job	Edu	ln_wage
Sex	1.0000				
Age	-0.0400	1.0000			
Job	0.0752	0.1035	1.0000		
Edu	0.1950	-0.0111	0.2215	1.0000	
ln_wage	-0.1073	0.1008	0.2939	0.3754	1.0000

Table 4 Heteroscedasticity

```
. estat hettest
```

Breusch-Pagan / Cook-Weisberg test for heteroskedasticity Ho:
Constant variance
Variables: fitted values of ln_wage

chi2(1)	=	137.57
Prob > chi2	=	0.0000

Table 5 Distribution of Standardized Residuals

```
. sktest Resid
```

Skewness/Kurtosis tests for Normality

Variable	Obs	Pr(Skewness)	Pr(Kurtosis)	adj chi2(2)	Prob>chi2
Resid	4.7e+03	0.0000	0.0000	.	0.0000

joint

Table 6 Expected Value of Residuals

One-sample t test

Variable	Obs	Mean	Std. Err.	Std. Dev.	[99.9% Conf. Interval]
Resid	4721	.0000227	.0145574	1.000231	-.0479088 .0479542

mean = mean(Resid) t = 0.0016
Ho: mean = 0 degrees of freedom = 4720

Ha: mean < 0 Ha: mean != 0 Ha: mean > 0
Pr(T < t) = 0.5006 Pr(|T| > |t|) = 0.9988 Pr(T > t) = 0.4994

Table 7 Oaxaca Blinder

. oaxaca ln_wage Age Age_sq Edu Job D_2, by(Sex) noisily

Model for group 1

Source	SS	df	MS	Number of obs	2832
Model	104.417311	5	20.8834621	F(5, 2826)	122.12
Residual	483.265618	2826	.171006942	Prob > F	0.0000
Total	587.682929	2831	.20758846	R-squared	0.1777
				Adj R-squared	0.1762
				Root MSE	.41353

ln_wage	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]
Age	.0282444	.0050396	5.60	0.000	.0183627 .0381261
Age_sq	-.0003144	.0000576	-5.46	0.000	-.0004273 -.0002015
Edu	.1420068	.0107314	13.23	0.000	.1209645 .1630491
Job	.3265343	.0229791	14.21	0.000	.2814767 .3715918
D_2	.0581554	.0244255	2.38	0.017	.0102618 .106049
_cons	11.13623	.1019102	109.27	0.000	10.9364 11.33606

Model for group 2

Source	SS	df	MS	Number of obs	1889
Model	123.786325	5	24.7572649	F(5, 1883)	237.62
Residual	196.189299	1883	.10418975	Prob > F	0.0000
Total	319.975624	1888	.169478614	R-squared	0.3869
				Adj R-squared	0.3852
				Root MSE	.32278

ln_wage	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]
Age	-.0037131	.004805	-0.77	0.440	-.0131367 .0057105
Age_sq	.000087	.000057	1.53	0.127	-.0000247 .0001987
Edu	.3092059	.0100426	30.79	0.000	.28951 .3289017
Job	.2476817	.0262281	9.44	0.000	.1962424 .2991209
D_2	.0210176	.0182223	1.15	0.249	-.0147204 .0567555
_cons	11.3586	.1021771	111.17	0.000	11.15821 11.55899

Blinder-Oaxaca decomposition

Number of obs = 4721

1: Sex = 1

2: Sex = 2

ln_wage	Coef.	Std. Err.	z	P> z	[95% Conf. Interval]
Differential					
Prediction_1	12.64975	.0085678	1476.42	0.000	12.63296 12.66654
Prediction_2	12.55312	.0094797	1324.21	0.000	12.53454 12.5717
Difference	.0966286	.0127778	7.56	0.000	.0715845 .1216726
Decomposition					
Endowments	-.1005247	.0086424	-11.63	0.000	-.1174634 -.083586
Coefficients	.1632674	.0118273	13.80	0.000	.1400863 .1864485
Interaction	.0338859	.0066648	5.08	0.000	.0208231 .0469486

SHËRBIMI CIVIL SHQIPTAR DHE RISITË E LIGJIT TË RI “PËR NËPUNËSIN CIVIL”

PROF. ASOC. DR. MIGENA LESKOVIKU

Zv/Dekane e Fakultetit Juridik&Pergjegjese e Departamentit te se Drejtes Publike, Fakulteti Juridik, UET

ABSTRAKT

Reformimi i Administratës Publike është bërë tashmë një çështje komplekse gjithnjë e më tepër në fokus të qeverisjes së sotme. Konceptimi i administratës publike si një administratë e përgjegjshme dhe e besueshme për qytetarët konsiderohet si një nga qëllimet e qeverisjes demokratike. Që një sistem qeverisje të realizojë me sukses misionin e tij duhet një aparat shtetëror sa më i organizuar dhe efektiv, me individë të aftë dhe të përgatitur që të shërbejnë sa më mirë funksionet publike. Në shtetin e së drejtës ekziston gjithmonë tendenca e balancimit të pushteteve dhe e ndjenjës së drejtësisë e cila duhet të mbulojë të gjithë spektrin e marrëdhënieve sociale.

Ligji i ri për shërbimin civil nuk mund të shihet i shkëputur nga reforma në administratën publike, përkundrazi është i lidhur ngushtë me aspektin reformues të saj. Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është i tretë, miratuar si rrjedhojë e problemeve që kishte shfaqur shërbimi civil në vite dhe gjithashtu për t’iu përshtatur nevojës për reformim në administratën publike, e lidhur kjo dhe me procesin e integritetit të vendit në BE.

Ligji ka për qëllim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike. Ligji rregullon marrëdhënien juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunësit civil dhe përcakton rregullat për administrimin e shërbimit civil, pra është marrëdhënie juridike e natyrës administrative.

Fjalë kyç: *administratë publike, shërbimi civil, nëpunës civil, qeverisja e mirë, shërbime publike*

Hyrje

Që një sistem qeverisje të realizojë me sukses misionin e tij duhet një aparat shtetëror sa më i organizuar dhe efektiv. Që kjo të realizohet në mënyrën më të mirë duhet patjetër që shteti të ketë njerëz të aftë dhe të përgatitur që t'i shërbejnë sa më mirë këtij aparati. Në shtetin e së drejtës ekziston gjithmonë tendenca e balancimit të pushteteve dhe e ndjenjës së drejtësisë e cila duhet të mbulojë të gjithë spektrin e marrëdhënieve sociale. Nga kjo lind dhe kufizimi që u vihet punonjësve për të përbushur detyrat e tyre brenda kuadrit ligjor dhe kushtetues. N.q.s hedhim një vështrim retrospektiv, vërejmë se deri në vitin 1996 nuk ka patur dallim midis marrëdhënies juridike të punësisë nga marrëdhëniet e tjera të punës që do të thotë burimi i vetëm rregullues ishte Kodi i Punës.

Në këto kushte, në 1996 në Shqipëri u miratua për herë të parë një ligj për shërbimin civil¹, i cili pati jetëgjatësi të shkurtër dhe u zëvendësua me ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil".

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 107 të saj parashikohet se nëpunësit publikë zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit. Ata caktohen me konkurs me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji; garancitë e qëndrimit në detyrë dhe trajtimi ligjor i nëpunësve publike rregullohen me ligj. Ky përcaktim kushtetues, mundësoi një rregullim të posaçëm të shërbimit civil përmes ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil".

Ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, (të cilit në vijim në këtë punim do t'i referohemi si Ligji) është i treti, miratuar si rrjedhojë e problemeve që kishte shfaqur shërbimi civil në vite dhe gjithashtu për t'iu përshtatur nevojës për reformim në administratën publike, e lidhur kjo dhe me procesin e integritetit të vendit. Kështu neni 111 i MSA-së² me titullin 'Administrata publike' thekson se "*Bashkëpunimi do të synojë mundësimin e zhvillimit të një administrate publike eficiente dhe të përgjegjshme në Shqipëri, e cila mbështet në veçanti vënien në zbatim të shtetit të së drejtës funksionimin e duhur të institucioneve shtetërore për të mirën e popullsisë shqiptare në tërësi dhe të zhvillimit normal të marrëdhënieve mes BE-së dhe Shqipërisë.*

Bashkëpunimi në këtë fushë do të përqendrohet kryesisht në ndërtimin e institucioneve, duke përfshirë zhvillimin dhe zbatimin e procedurave transparente dhe të paanshme të rekrutimit, menaxhimit e burimeve njerëzore, zhvillimin e karrierës në shërbimin publik, trajnimin e vazhdueshëm dhe promovimin e etikës në administratën publike dhe qeverisjes elektronike. Bashkëpunimi përfshin si administratën qendrore, ashtu dhe atë vendore".

Duke theksuar se **marrëdhënia e shërbimit civil është marrëdhënie juridike e natyrës administrative**, ky ligj përcakton qartë qëllimin për krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike.

Ligji rregullon marrëdhënien juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunësit civil dhe përcakton rregullat për administrimin e shërbimit civil.

Ligji aktual për shërbimin civil është një ligj i cili mbështetet kryesisht në një frymë sa të përgjithshme aq edhe specifike për mënyrën e rregullimeve ligjore për të gjithë ata persona që kategorizohen si nëpunës civilë.

Ligji për shërbimin civil nuk mund të konsiderohet kurrsesi thjesht si një ligj që merret me marrëdhëniet e punës për nëpunësit publikë. Ai është një ligj që rregullon një gamë të gjerë çështjesh në lidhje me qeverisjen, funksionet publike, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat e atyre funksionarëve që ushtrojnë pushtetin publik, ekzekutojnë urdhërimet ligjore, menaxhojnë fonde publike apo ofrojnë shërbime për publikun. Pra ai është një ligj që rregullon marrëdhënie të caktuara në fushën e të drejtës publike (të drejtës administrative, më konkretisht).

Reforma në administratën publike dhe risitë e Ligjit

Ligji për shërbimin civil nuk mund të shihet i shkëputur nga reforma në administratën publike, përkundrazi është i lidhur ngushtë me aspektin reformues të saj. Konkretisht ligji që në hyrje të tij shpreh se qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të njëjta për kushtet dhe procedurat e pranimit në shërbimin civil, për mënyrën e fillimit dhe mbarimit të marrëdhënieve të punës, për zhvillimin e karrierës, për garantimin e të drejtave dhe përcaktimin e detyrimeve të nëpunësve civilë, me synim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional dhe eficient³.

Gjithashtu, një nga synimet kryesore të këtij ligji është edhe rritja e besimit të publikut me rritjen e cilësisë së shërbimit që ofron administrata publike dhe përafrimin me standardet evropiane. Ligji i ri gjithashtu vendos bazat për një sistem të ri rekrutimi, karriere dhe promovimi në karrierë, si dhe të trajnimit e kualifikimit të nëpunësve civilë. Ky ligj përpiqet të adresojë problemin e rregullimit të sistemit të shpërblimit e pagave, duke paraqitur dhe siguruar nivele të larta të drejtësisë dhe transparencës; të zbusë diferencën ndërmjet pagave të sistemit privat dhe atij shtetëror, përmirësimin e cilësisë së punës si dhe mbajtjen e pranimit e një personeli të kualifikuar në sektorët prioritarë të administratës publike.

E.Dobjani (2010), *E drejta Administrative*, Perlat Voshtrina, Tiranë, fq. 284-285.

Ligji i parë i miratuar ishte ligji nr.8095, datë 21.03.1996 "Për Shërbimin Civil në Republikën e Shqipërisë".

Ligji Nr.9590 dt.27.07.2006 "Për Ratifikimin e Marëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të Shteteve të Tyre Anëtare" Në këtë kuadër dhe Rekomandimi nr.6 i Opinionit të Komisionit Evropian, parashikon forcimin e administratës publike shqiptare duke e lidhur këtë detyrim kryesisht me forcimin e shërbimit civil

Neni 1 i Ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Këtu dallojmë aspektin gjithpërfshirës dhe qëllimin pse ky ligj i shërben më së miri nëpunësve civilë në rregullimin e marrëdhënieve të tyre juridike dhe vetë administratës publike dhe institucioneve të tjera në punën e përditshme të tyre.

Ligji gjithashtu sqaron⁶ termat kyç dhe më të rëndësishëm në lidhje me administratën publike duke i dhënë një përkufizim të saktë dhe duke përcuruar dhe specifikat apo fushat e veprimit të secilit term. Po ashtu edhe koncepti i nëpunësit civil ka ndryshuar, duke bërë një përkufizim më të plotë të këtij koncepti. *"Nëpunës civil" është personi që kryen funksionin për ushtrimin e autoritetit administrativ, publik, në bazë të aftësisë dhe profesionalizimit, i cili merr pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre.*

Ligji zbatohet për çdo nëpunës civil, që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore, duke përfshirë raste të zyrtarëve të caktuar si dhe rregullimet e posaçme ligjore.

Ligji rregullon edhe kërkesat e përgjithshme për t'u pranuar në shërbimin civil duke zgjeruar dhe përmirësuar⁸ cilësitë/kriteret e përgjithshme që duhet të përmbushë individi konkurent, ku specifikimet janë shtuar në krahasim me ligjin e mëparshëm. Pranimi në shërbimin civil bazohet në parimet e: shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale, mosdiskriminimit dhe kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë.

Procesi përzgjedhës bazohet në vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve nëpërmjet një konkurrimi kombëtar, që përfshin një testim të shkruar, një testim me gojë dhe çdo formë tjetër të përshtatshme të verifikimit të aftësive, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatit.

Nisur nga problematika e hasur më herët në praktikë në lidhje me procedurën e pranimit/rekrutimit në shërbimin civil, për shkak të ndikimit politik dhe një fryme jo konkurrence mbi meritokracinë që specifikisht ligji i mëparshëm e kërkonte, rregullimi aktual synon të përmirësojë procedurën e pranimit që të shmangë fenomene të tilla që asocohen me punësimin në administratën publike, përmes garancive më të mëdha në lidhje me këtë proces. Ligji i ri synon që të vendosë një vijë ndarëse midis politikës dhe administratës⁹, në mënyrë që rekrutimi dhe promovimi të jenë të bazuara në "Meritat", në vlerat e vërteta profesionale të një personi që kërkon të hyjë në administratën publike dhe kërkon të bëjë karrierë në të dhe jo në marrëdhëniet politike apo personale.

Synohet rritja e qëndrueshmërisë së punonjësve të administratës publike nëpërmjet zbatimit me rigorozitet të procedurave të përcaktuara nga ligji, duke i forcuar këto kapacitete dhe nëpërmjet trajnimit të thelluar dhe të vazhdueshëm sidomos në përmirësimin e aftësive menaxhuese e drejtuese të shërbimit civil shqiptar. Këtij qëllimi i shërben edhe garantimi i të drejtave që u njihen nëpunësve civilë, të drejta dhe garanci që janë shtuar dhe përmirësuar ndjeshëm me kuadrin ligjor aktual, duke reflektuar qasjen kushtetuese në lidhje me të drejtat dhe liritë kushtetuese që i njihen individit¹⁰. Në gamën e këtyre të drejtave përfshihen: *e drejta e kushteve të përshtatshme të punës dhe e drejta e mbrojtjes nga shteti; e drejta e pagës dhe struktura e saj; e drejta e grevës; e drejta e anëtarësimit në sindikatat dhe shoqatat profesionale; të drejtat politike sipas përcaktimeve në ligj; e drejta e formimit profesional; e drejta e konsultimit; e drejta e nëpunësit civil për pushime vjetore të paguara, si dhe për pushime të tjera me apo pa pagesë; e drejta e informimit dhe ankimit*¹¹.

Të drejtat themelore janë të kufizuara për nëpunësit civilë për hir të një profesionalizmi specifik që do të thotë një pjesëmarrje jo e lirë në drejtimin e partive politike dhe jo të drejtën për t'u marrë lirisht me aktivitete sipërmarrëse që janë ligjore për pjesën tjetër të qytetarëve. Këto kufizime që synojnë të shmangin konfliktin e interesit apo fenomene korruptive, kanë qëllim garantimin e një administrate publike me eficientë dhe një qeverisje të mirë. Përgjegjësitë për menaxhimin e shërbimit civil janë plotësisht të ndara në Këshillin e Ministrave (si drejtues politik), Departamentin e Administratës Publike (si përgjegjës për menaxhimin), Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) dhe Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil).

Një hap tjetër pozitiv lidhet me zbatimin e legjislacionit nëpërmjet rregullimit të procedurës së risistemimit të nëpunësve civilë pas ndryshimit të strukturës dhe organikës së institucionit dhe mbajtjen në kufij të kontrolluar të numrit të punësimeve me kontratë të përkohshme në shërbimin civil duke disiplinuar procedurën e kontratave dhe kushtëzuar marrjet në punë me miratime paraprake të kontrolluara, krijimin e një sistemi më të fortë karriere në administratën publike dhe unifikimi i procedurave në menaxhimin e burimeve njerëzore.

Ligji krijon mundësinë për krijimin e *Trupës së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND)*¹². Pranimi në programin e formimit të thelluar për TND-në në ASPA bëhet nëpërmjet një konkursi kombëtar, i cili është i hapur vetëm për nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese dhe nëpunësit e nivelit të lartë drejtues në institucionet e pavarura, si dhe për çdo individ tjetër, që nuk është pjesë e shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në TND. Pranimi në TND mund të bëhet vetëm nga personat që kanë përfunduar formimin e thelluar në ASPA përmes konkurrimit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj.

Pranimi i drejtpërdrejtë në TND është një alternativë tjetër e parashikuar në ligj për të mundësuar thithjen e profesionistëve dhe individëve të kualifikuar në shërbimin civil.

Po ashtu gjen rregullim më të plotë në Ligj, lëvizja paralele që kryhet nëpërmjet një procedure me konkurrim të brendshëm të bazuar në pozicionin (konkurrim për një pozicion të caktuar) me qëllim përzgjedhjen e kandidatit më të mirë të mundshëm brenda shërbimit civil; ngritja në detyrë do të bazohet në një konkurrim të hapur, të organizuar për një pozicion të caktuar. Ligji ri parashikon dhe transferimin si instrument të mobilitetit dhe të pasurimit të karrierës.

Neni 2 i Ligjit

Neni 4/c i Ligjit

Neni 21 i Ligjit

Draft dokumenti zyrtar për ligjin e ri të shërbimit civil, OSBE, 2011, Tiranë

Shih Kreun VII të Ligjit, me titull "Të drejtat dhe detyrimet në shërbimin civil".

Shih nenet 33-41 të Ligjit

Kreu VI i Ligjit, nenet 27-32.

Sfidat në administratën publike (posaçërisht në shërbimin civil) vijnë si përgjigje e nevojave për zbatimin e objektivave për zhvillimin e vendit dhe konsistojnë në disa komponentë si: zbatimin e një sistemi menaxhimi eficient të burimeve njerëzore për administratën publike si dhe monitorimin e këtij sistemi; përmirësimin e performancës dhe zhvillimin e kapaciteteve të administratës publike, përfshirë programet e trajnimit dhe kualifikimit afatshkurtër e afatgjatë; përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen publikut, nëpërmjet fuqizimit të strukturave ekzistuese dhe ngritjes së strukturave të reja; rritjen e përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë nëpërmjet delegimit të vendim- marrjes sa më pranë pozicionit të ngarkuar për ushtrimin e funksionit; politikat e burimeve njerëzore dhe sistemi i pagave në administratën publike, etj.

Përmirësi i shërbimit civil mbi bazën e parimeve kryesore mbi të cilat ai organizohet dhe funksionon shihet i lidhur ngushtë me reformën në administratën publike shqiptare dhe po ashtu edhe me reformën në drejtësinë administrative. Reforma në Administratën Publike në vazhden e objektivave dhe përmbushjes së prioriteteve të përcaktuara mbetet angazhimi për një administratë apolitike, profesionale, transparente, efikase me një strukturë dhe organizim efektiv horizontal dhe vertikal të institucioneve të administratës publike në harmoni me përgjegjësitë e tyre, ku komunikimi efektiv dhe reciprok me qytetarët në zhvillimin e politikave dhe ofrimin e shërbimeve konsiderohet faktor i rëndësishëm në performancën e një administrate publike moderne në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare¹³.

Krijimi i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil si organi përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, është një garanci më shumë për kontrollin dhe monitorimin mbi shërbimin civil dhe respektimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë¹⁴.

Gjykata efikase administrative rrisin gjithashtu transparencën e vendimeve administrative, gjithashtu mund të luajnë një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit dhe kontrolli gjyqësor i veprimeve publike administrative nga një gjyqësor administrativ që funksionon mirë është përveç pikëpamjes strikte ligjore të çështjeve individuale, edhe një forcë stimuluese për modernizimin e administratës publike, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve të saj dhe si pasojë, rrit besimin e qytetarëve për institucionet shtetërore. Krahas këtij roli mbrojtës, kontrolli gjyqësor shihet si një mjet i rëndësishëm në rritjen e cilësisë së administrimit dhe qeverisjes së mirë.

Përfundime

Zgjerimi i sektorit publik dhe rritja e kompleksitetit të vendim-marrjes administrative ka një ndikim të dyfishtë: nga njëra anë ka sjellë forma të reja të aktivitetit administrativ dhe rritje të kërkesës për fleksibilitet të administratës në shërbim të interesit publik dhe nga ana tjetër efektet e një zgjerimi të tillë mbi jetën individuale janë duke u rritur vazhdimisht. Sot administrata publike ka bërë hapa pozitive në përmirësimin e kësaj situate edhe me ligjin e ri për nëpunësin civil¹⁴, i ndërtuar në përputhje me *acquis communautaire* duke krijuar premisat për të përmirësuar situatën në shërbimin civil shqiptar e duke treguar dhe njëherë angazhimin që sot ka Shqipëria dhe administrata publike për të ndërmarrë reforma drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Ligji i ri duke parë dhe problematikën e mëparshme dhe për të evituar atë, forcon akoma më tej procesin e rekrutimit, si dhe mbrojtjen dhe garancitë e nëpunësit civil, për të pasur një shërbim civil të standarteve evropiane, për të mundësuar krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike.

Nisur nga natyra e ligjit dhe objekti e fusha e zbatimit të tij, ajo çka kërkohet dhe ka rëndësi është zbatueshmëria e tij¹⁵, gjë e cila do e çonte akoma dhe më përpara përmirësimin e situatës në administratën publike dhe posaçërisht shërbimin civil shqiptar.

Bibliografia

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
Ligji Nr.9590 dt.27.07.2006 “Për Ratifikimin e Marëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të Shteteve të Tyre Anëtare”
Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
Vendim i Gjykatës Kushtetuese, Nr. 5, datë 5.2.2014
Ermir Dobjani (2010), *E drejta Administrative*, Perlat Voshtina, Tiranë
Migena Leskoviku (2014), *Administrata publike dhe reformimi i saj në kuadër të sfidave globale dhe proceseve integruese të vendit*, Jus&Justicia, Nr.8, Tiranë, Uet Press.
Bajram Pollozhani; Esat Stavileci; Ermir Dobjani & Lazim Salihu (2010), *E drejta administrative, aspekte krahasuese*, Botues ‘Asdreni’, Tetovë, Maqedoni.
Sokol Sadushi, (2008), *E drejtë administrative 2*, Toena, Tiranë.
Draft dokumenti zyrtar për ligjin e ri të shërbimit civil, OSBE (2011), Tiranë

M. Leskoviku (2014), “*Administrata publike dhe reformimi i saj në kuadër të sfidave globale dhe proceseve integruese të vendit*”, Jus&Justicia, Nr.8, fq. 41-51.

Draft dokumenti zyrtar për ligjin e ri të shërbimit civil, OSBE, 2011, Tiranë
Shih më gjerë edhe Vendimin e Gjykatës Kushtetuese, Nr. 5, datë 5.2.2014

HISTORI E SË DREJTËS CIVILE NË SHQIPËRI

DR. ÇLIRIM DURO

ABSTRAKT

Kjo kumtesë ka të bëjë me një vështrim historik mbi ecurinë e së drejtës civile në Shqipëri, e cila lidhet me vitin 1912 kur ndodhi dhe akti i shpalljes së Pavarësisë. Kumtesa e historisë së të drejtës civile në periudhën pas viteve 1912 na jep një informacion të përgjithshme për zhvillimin e rolin e saj deri në vitet 90 të shekullit të njëzetë. Përpara shpalljes së pavarësisë në Shqipëri, për vet natyrën e saj në vend kishin mbizotëruar e drejta zakonore Shqiptare (kanunet) dhe e drejta Osmane si një e drejtë e pushtetit. Këto dy burime të së drejtës sa vinin e modernizoheshin, përshtateshin me kohën dhe paraqiteshin me një formë më të pranueshme derisa edhe njiheshin si të drejta "shtetnore" me karakter të përgjithshëm dhe imponues. Janë tre periudha në të cilin do të fokusohet kjo kumtesë. E drejta civile në vitet 1912-1924, periudha e kohës së Mbretërisë Shqiptare dhe periudha e viteve të regjimit komunist. Megjithatë studimi i historisë së të drejtës civile paraqet jo vetëm rendin historik, por edhe aktual, sepse shërben si model për të arritur edhe e drejta jonë civile në standardet evropiane.

Fjalë kyç: *Historia e së drejtës civile, legjislacioni, kodi civil*

Shqipëria në vitet 1912-1924

Në vështrimin historik që i bëhet sistemit të drejtës civile në Shqipëri hapi i parë në të cilin shënohet krijimi i Institucioneve të shtetit shqiptar është periudha e viteve 1912-1920. Shpallja e pavarësisë, shënoi hapat e para në krijimin e institucioneve të shtetit të ri shqiptar, ku Kuvendi i Vlorës dhe Qeveria e kryesuar nga Ismail Qemal bej Vlora, krahas iniciativave të rëndësishme për krijimin e organeve kryesore të pushtetit legjislativ e ekzekutiv, u fokusuan dhe mbi riorganizimin e pushtetit gjyqësor.

Institucionet shtetërore të asaj kohe, të cilat diktonin nevoja të rëndësishme në drejtim të krijimit dhe organizimit të shtetit të sapokrijuar, Qeveria e Përkohshme e Vlorës në fushën civile la në fuqi legjislacionin civil ekzistues Osman.

Megjithatë, krahas krijimit të Institucioneve shtetërore Qeveria e sapokrijuar e asaj kohe brënda një periudhe të shkurtër ndërmori masa për të riorganizuar sistemin e drejtësisë civile të shtetit të ri shqiptar. Në këtë drejtim shënon një hap të rëndësishëm miratimi në datën 10 Maj të vitit 1913 të “Kanunit të Zhurisë”. Data e miratimit të këtij akti 10 Maji, njihet zyrtarisht në Shqipëri si “Dita e Drejtësisë”.

“Kanuni i Zhurisë” parashikonte krijimin e “Gjykatës së Diktimit” dhe gjithashtu parashikonte krijimin edhe të Gjykatave të shkallës së parë të nënprefekturave, të cilat kishin në kompetencë gjykimin e çështjeve civile si dhe të çështjeve penale. Po kështu, parashikohej krijimi i Gjykatës me Juri, ku përfaqësues të popullit merrnin pjesë në gjykimin çështjeve. Në fakt, kjo Gjykatë është vënë në jetë vetëm një herë në Elbasan dhe duke qënë se nuk dha rezultatet që priteshin u anulua krijimi i kësaj Gjykate me dekretin e datës 4 qershor të vitit 1914.

Situata e re që u gjend shtetit shqiptar pas shpalljes së pavarësisë, e vendosi në veshitësi përqendrimin në rregullimin e një fushe të caktuar, për këtë arsye edhe sistemi i drejtësisë në fillim u vertit në një labirint zgjedhjesh të vulltshme të shtetit të ri. Meqenëse u përhap një frymë demokratike në qeverisje, edhe normat juridike u synuan të formoheshin nga kjo frymë e re. Gjate kësaj periudhe në fuqi ishte Qeveria Kombëtare e Vlores.

Qeveria e krijuar nuk arriti dot ta persoste këtë sistem juridik të futjes së normave të reja, pasi edhe jeta e saj ishte e shkurter. Në 1914 detyrohet të japë dorëheqjen, dhe pushteti i kalon Komisionit Nderkombëtar të Kontrollit.

Rregullimi i marrëdhënieve të trashëgimise po ashtu u rregullua nga e drejta osmane. Marrëdhëniet e trashëgimise nuk rregulloheshin nga Kodi Civil por sipas të drejtës së shenjete. Sipas kësaj të drejte trashëgimtare ligjor ndaheshin në: trashëgimtar me pjesë të caktuar, trashëgimtar pa pjesë të caktuar

E drejta civile sipas Statutit Organik 1914

Pavarësisht trysnise që ushtronin shtetet e tjera, me ardhjen e Princ Vidit, sistemi juridik civil u shtrua në mënyrë me të vulltshme. Në këto vite, si akt i rëndësishëm themelor i Shtetit të parë Shqiptar është **Statuti Organik i 10 Prill-it 1914**,² i hartuar nga Komisioni Nderkombëtar i Kontrollit.³ Në këtë statut, karakteristike kryesore ishte identifikimi i qarte i ndarjes së pushteteve në: *legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor*. Në këtë statut, dhe pikërisht në Kapitullin e 10-te, pika 159 e tij, përcaktohej qarte struktura organizative e autoriteteve gjyqësore, që përbehej nga:

- Keshilli i pleqve;
- gjyqatesit paqtues;
- gjykatat e shkallës së parë;
- gjykatat e apelit.⁴

Organizimi gjyqësor i asaj kohe përfshinte këto hallka: *keshillin e pleqve, gjyqatesit paqtues, gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit*.

Gjyqatesit paqtues rregulloheshin pa apel në fushën civile mosmarrveshjet për shumat deri në 100 franga, dhe me apel konfliktet deri në 500 franga. Gjykatat e shkallës së parë kishin edhe shtrirje me të gjere veprimi. Ato gjyktonin pa apel konfliktet për shumat nga 500 deri 1000 franga, dhe me apel të gjitha konfliktet e tjera civile. Përsa i përket gjykatave të apelit, ato do të ishin tre të cilat do të rregulloheshin në fushën civile të gjithë konfliktet e shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë.

Statuti, në një kre të vecante të tij trajton edhe problemet e pronesise mbi token. Pasuritë e patundshme ndaheshin në: pasuri private të personave fizike ose juridike, 2) pasuri publike ose shtetërore, 3) pasuri të kishave ose vakefeve, të lena në trashëgimi institucioneve fetare.

E drejta civile në vitin 1924

Në vitet 1920-1924 problemet kryesore në fushën e së drejtës, që paraqisnin rëndësi të madhe për shtetin tonë, ishin reforma ligjore, riorganizimi i organeve gjyqësore dhe aftësimi i kadrove të tyre. Gjatë kësaj periudhe filloi të kristalizohej më mirë organizimi dhe funksionimi i sistemit gjyqësor.

Historia e Gjykatave Shqiptare, Tirana 2000, f.43.

Historia e Shtetit dhe e se Drejtës në Shqipëri – Luarasi University Press, Tirane 2007, fq. 322-323.

“Statuti Organik i Shqipërisë”, Dok, 152, - shih Prof. Arben Puto, vep. e cit., fq. 572, po aty fq. 593.

“Statuti Organik i Shqipërisë”, Dok, 152, - shih Prof. Arben Puto, vep. e cit., fq. 572,

Ashtu sic parashikonte edhe programet e qeverive nje pjese e rendesishme e vemendjes perqendrohej ne sistemin juridik te vendit. Juristet e rinj hasnin veshtiresi te shumta pasi njohurite e tyre te marra ne vendet evropiane nuk perputheshin me legjislacionin e shkruar ne turqisht. Nevoja per ekzistencen e nje Kodi Civil po shtrohej gjeresisht edhe nepermjet shtypit te asaj kohe. Keshtu psh. Gazeta "Politika" e dt. 10 korrik 1924 shkruante: "*Te behet Kodi Civil i cili te permbaje dispozita moderne mbi marrredheniet e shtetasve sipas nevojave, psikologjise dhe mentalitetit te sotem*". Qeveria e qershorit 1924 kishte nisur punes per pergatitjen e reformave me frymen e Evropes Perendimore ne menyre qe te shkeputej krejtesisht prej legjislacionit turk. Nje deklarate mbi kete beri ministri i Drejtesise se asaj kohe Stavro Vinjau ne intervisten per gazerten "Bashkimi" me 29 gusht 1924: "*Reformat qe pergatitim iu perkasin ligjeve me te vjeteruara dhe me te rendesishme. Keto jane: Kodi Tregtar, Kodi Civil sidomos pjesa e trashigimise dhe e se drejtes familjare dhe Procedura Civile. Te gjitha keto do te jene te mbaruara Brenda 6 muajve dhe deri ateherë do te vihen ne zbatim pjese pjese nepermjet dekretligjeve*"⁵

Ndryshimet ne te drejten civile dhe te detyrimeve mbeshteten me se tepermi rrugen per zhvillimin kapitalist te vendit. Iu kushtua shume rendsesi vendosjes se sistemit te kontratave ne industri, ashtu edhe ne bujqesi cka favorizoi mardheniet borgjeze ne prodhim. Ne te drejten familjare parashikohej vendosja e nje sistemi unik legjislativ shteteror, me karakter demokratiko-borgjez. Nje ceshtje per diskutim mbeti edhe pranimi i Kanunit te Lek Dukagjinit pasi vete situatë kerkonte te dyja edhe institutin e beses per te mbajtur nen kontroll qertesine e vendit edhe perpjekjet per te zhdukur te metat e te drejtes zakonore shqiptare.

E drejta civile ne vitet 1929-1939

Per sa i perket periudhes se Monarkise, 1928-1939, ne statutin qe shpallte Shqiperine "*...Mbretini (Royaume) demokratike parlamentare dhe e trashegueshme*", parashikoheshin perseri ndryshime struktorore te organizimit shteteror. Ketu nuk lihej jashte vemendjes edhe sistemi gjyqesor. Ne kete statut, ne vijim edhe te frymes te statutit te republikes, "*de jure*", pasi ngjarjet qe rrodhen me vone, ne lidhje me vendimmarrje te pavarur te gjykatave te kohes, treguan dicka tjeter nga sa parashikohej, u perfshine perseri nje sere parimesh demokratike qe i perkisnin fushes te se drejtes, si; "Gjyqtaret, ne te dhanunit e vendimeve, jane te pamvarun dhe udhehiqen vetem prej ligjes e ndergjegjes se tyne; askush nuk mund t'intervenoje dhe t'influencoje ne dhanjen e vendimeve gjyqesore."⁶ *me synimin per sigurimin dhe garantimin e pavaresise se gjyqtareve ne punen e tyre. Mbi te drejten e mbrojtjes per te drejtat e individeve - Art. 122 i ketij Statuti percaktonte se: "Cdo person ka te drejte me mbrojte te drejtat e veta me menytrat e pranueshme prej ligjes."*⁷ *apo detyrueshmeria e gjykatave per shqyrtimin e geshtjeve qe i paraqiten asaj per shqyrtim dhe qe jane kompetence e saja (Art. 126) "Asnji gjyq, nuk mund te refuzoje shikimin e geshtjeve qe jane mbrenda ne kompetencen dhe ne detyren e tij..."*⁸

Kodi Civil i Mbretërisë Shqipëtare i cili hyri në fuqi me 1 prill 1929 u hartua mbi bazën e kodit më modern të asaj kohe, Kodit Civil të Napoleonit, i cili ka ushtruar ndikim të madh në shumë shtete të tjera e sidomos tek Kodi Civil italian dhe ai zvicerian. Kodi Civil i mbretit Zog pati rëndësi të madhe në atë kohë sepse për herë të parë vendosi mbi baza ligjore marrëdhëniet familjare, të cilat do të ishin unike për të gjithë Shqipërinë. Ishte tepër e vështirë që ai të gjente zbatim, sidomos kur ndikimi i rregullave të kanuneve dhe normave fetare ishte tepër i fuqishëm dhe i vazhdueshëm. Procesi i pershtatjes dhe i ndryshimeve te legjislacionit nuk la jashte edhe aspektin procedural te aplikimit te ligjeve te reja materiale. Keshtu, ne fushen procedurale civile, duke evidentuar mangesite dhe aplikimin praktik qe shfaqti, qe me hyrjen ne fuqi shtojca e pare ne fushen procedurale civile, pershtatshmeria e paket me legjislacionin modern te miratuar per ate periudhe te kesaj te fundit dhe procesi i vazhdueshem i miratimit te ligjeve te tjera me kendveshtrim perendimor, solli si produkt te kohes shtojcen e dyte te kodit te procedures me ligjin "*Mbi shtojcen e dyte te procedures civile*" i miratuar ne vitin 1929. Mgjithate perpjekja reale e mbreterise ishte shperndarja e gjykatave fetare.

Sic eshte cituar edhe me siper burimet e ketij Kodi Civil ishin:

Kodi Civil francez ose napoleonian

Kodi Civil zvicerian.

Kodi zvicerian i Obligimeve

Kodi gjerman

Pretendohet qe te quhet burim i tij edhe Kodi Civil Italian⁹, por nuk eshte pranuar me argumentin se ky i fundit ka si burim Kodin francez. Per nga perberja Kodi Civil ndertohej nga nje hyrje qe shprehte dispozita te pergjithshme mbi zbatimin dhe interpretimin e ligjeve, si edhe nga kater libra te tjere ose pjese. Keto libra ndaheshin ne:

Libri i pare: "Personat dhe familja"

Libri i dyte : Dispozita "Mbi trashgimime ligjore dhe testamentare".

Libri i trete: Dispozita "Mbi sendet, zoterimin dhe mbi modifikimin e tij".

Libri i katert: Dispozita "Mbi menytrat e fitimit dhe te transferimit te pronesise si edhe te te drejtave mbi sendet".

⁵ Historia e Shtetit dhe e se Drejtes ne Shqiperi – Luarasi Uniuersity Press, Tirane 2007 Fq.354

⁶ Artikulli 118, parag. 2 - "Statuti Themeltar i Mbretnis Shqiptare", fq.1.

Po aty, fq. 15.

Po aty, fq. 16.

Baltasar Benussi, *Komentar i Kodit Civil- Sendet Zotenimi dhe modifikimet e tija (Libri i III I KC)*; Botim i Ministrise se Drejtesise, 1931; fq 3

E drejta civile ne vitet 1944-1990

Pas perfundimit te luftes se dyte boterore pushtetin e moren forcat komuniste te cilat sollen nje fryme krejt te re dhe te panjohur per shtetin shqiptar.

Duke u evidentuar domosdoshmeria e ngritjes se strukturave te reja shtetor, domosdoshmeri kjo qe kerkonte dhe nje sistem te mirefillte drejtesie dhe nje organizim gjyqesor te strukturuar mire, qe do ndikonte pozitivisht ne strukturen e pergjithshme shtetore qe po formohet nga forca e ardhur ne pushtet, u miratua Ligji Nr. 59 date 17 Maj 1945 “Mbi Organizimin e perkoheshme gjyqesor” nga Kryesia e Keshillit Antifashist Nacional Qlirimtar.¹⁰ Me ane te ketij ligji u vendos ngritja e nje sistemi drejtesie te mirefillte duke percaktuar ngritjen e strukturave te konsoliduara dhe qe do “fokusoheshin” vetem ne dhenien e drejtesise, duke shqyrtuar ne kompetenca te plota ceshtjet civile.¹¹ Sipas percaktimeve te ketij ligji “Drejtesija ne lende civile dhe penale jepet prej gjykatave, qe krijohen dhe veprojne si pas kesaj ligje, me pjesemarrjen e gjyqtareve te zgjedhur prej popullit dhe te gjyqtareve te rendeshem.”¹² por, pavaresisht kesaj tendence per t’ia lene organeve te specializuara dhenien e drejtesise, perseri parimi i “drejtesise popullore” apo ai sic njihej ndryshe, parimi i “pjesemarrjes se popullit ne dhenien e drejtesise” u be pjese e ketij ligji duke u pasqyruar ne vete strukturen e ketij sistemi, sic konstatohet nga perberja e gjykatave popullore,¹³ gjykatave te prefektures. Struktura gjyqesore parashikohej me tre shkalle¹⁴ dhe perbehej nga:

Gjykatat Popullore, te cilat do te ngriheshin “ne gdo qender prefektore dhe ne qendrat e nenprefekturave...” *Kompetenca e ketyre gjykatave ne fushen civile shtrihet mbi te gjitha* “...padinat, objekti i te cilave ne teresi nukkalon te 6000fr.shqip...”^m

2. Gjykatat e Prefektures te cilat ngriheshin dhe shtrinin juridiksionin e tyre: “ne cdo qender Prefektore , juridiksioni i se ciles shtrihet mbi gjithe qarkun e

3. Gjykates se Nalte me qender ne Tirane ku “juridiksioni i se ciles shtrihet mbi gjithe Shqiperine”.¹⁵ *Kjo gjykate parashikohej te kishte ne perberjen e saj* “...nje numer prej 8-10 gjyqtar te rendeshem nga te cilet dy Kryetare...” dhe percaktonte qe “... ushtron funksionet e saj me ane te Keshillit te Pergjithshem dhe dy seksioneve.

Me ligjin per organizimin gjyqesor, viti 1951, Gjykata e Larte ndahej ne keto kolegje gjyqesore:

Kolegji penal
Kolegji civil
Kolegji ushtarak
Kolegji disiplinor

Pra pervec gjykatave te shkalleve te ndryshme ne vitin 1951 kemi me ligj dhe nje kolegje vetem per te drejten civile.

Ne ligjet e mevonshme qe perbenin ligjet ne fuqi ishin te dukshme karakteristikat e se drejtes socialiste te cilat e moren formen e tyre me te plote ne Kodin Civil te 1981. Kjo karakteristike e saj vinte si pasoje e asaj qe juristet qe e hartuan ate ishin arsimuar ne shkolla sovjetike, megjithate nuk mund te themi qe qofte edhe ne menyre indirekte keto juriste nuk ishin perpjekur per te futur edhe elemente te se drejtes gjermanike.

Organizimi gjyqesor ne fushen civile dhe ndryshimet e bera me Ligjin nr. 4406, dt. 24.06.1968

Ky organizim gjyqesor sipas ligjit nr. 1284, dt. 09.06.1951 vijoi deri me miratimin e ligjit te ri nr. 4406, dt. 24.06.1968 “Mbi Organizimin Gjyqesor te R.P.SH.”,¹⁶ me te cilin u bene transformime te tjera strukturore te organizimit te gjykatave te cilat vijuan edhe ne vitet e mevonshme. Keshtu, mund te permenden ato qe u bene ne lidhje me gjykatat popullore, te cilat perbeheshin nga - “...Gjykata e Larte, gjykatat e rretheve, gjykatat e fshtrave, te qyteteve dhe te lagjeve te qyteteve...”

Ky ligj suprimoi nga struktura gjykatat e qarqeve, te cilat, per periudhen te ciles i referohemi, u konsideruan si hallka te ndermjetme dhe te panevojshme qe qendronin midis Gjykates se Larte dhe gjykatave te bazes.

Jashte ndryshimeve nuk qendruan as Gjykatat Ushtarake, te cilat u suprimuan si hallka me vete nga hallkat e tjera te sistemit gjyqesor te asaj kohe, duke u krijuar kolegjet ushtarake prane gjykatave te rretheve, trupat gjyqesore te te cilave gjykonin te perbera nga nje gjyqtar ushtarak dhe ndihmesgjyqtare po ushtarak, te cilet kishin kompetence te gjykonin pervec ceshtjeve te kesaj lende edhe geshtje te tjera civile apo penale, kjo ne kuader te “unitetit te gjykatave” dhe ekonomise ne gjykim.

Gjykatat e fshtrave dhe qyteteve dhe te lagjeve te qyteteve kishin kompetence gjykimi mbi ceshtje te fushes penale te nje karakteri me rrezikshmeri te ulet shoqerore dhe ceshtje te thjeshta civile, si dhe kundravajtjet.

AQSH F. 490, Viti 1945, D. 265, fl.3- Ligji “Mbi Organizimin e perkoheshme gjyqesor”.

Dr. Koco Nova, vep. e cit., fq. 119.

“Mbi Organizimin e perkoheshme gjyqesor”, AQSH F. 490, Viti 1945, D. 265, fl.3.

AQSH F.490, Viti 1951, D. 1794, fq.5.

AQSH F. 490, Viti 1945, D. 265, fq.7.

Kjo struktura u be pjese edhe e Kushtetutes se Republikes Popullore te Shqiperise, te vitit 1946 (aprovuar me 14.03.1946 dhe shpallur me Dekretine Asamblese Kushtetuese me Dekret Nr. 24, dt. 15.3.1946).

Permbledhje e Pergjithshme e Legjislacionit ne Fuqi te R.P.SH. 1045-1971, Shtypshkronja “Mihal Duri”, Stabilimenti “8 Nentori”,

Tirane 1971 (botuar ne Gazeten Zyrtare Nr. 7 viti 1968).

Gjykatat e rretheve, qe konsideroheshin si hallka themelore te sistemit gjyqesor te asaj kohe, gjykonin te gjitha ceshtjet e tjera penale e civile. Keto gjykata ne disa raste funksiononin si gjykata te shkalles se dyte per ankime dhe protesta ndaj vendimeve te gjykatave te fshatrave dhe qyteteve dhe lagjeve te qyteteve. Prane ketyre gjykatave te rretheve funksiononte edhe kolegji ushtarak, i perbere nga gjyqtare dhe ndihmesgjyqtare ushtarake. Keto gjykata si strukture organizative perbeheshin nga kryetari, zevendes kryetari, gjyqtaret dhe ndihmes-gjyqtaret.

Nder ndryshime te tjera, qe u bene me ligjin e ri, ne keto struktura ishte edhe krijimi i keshillave gjyqesore¹⁷ prane gjykatave te rretheve, si instance te shkalles se dyte.¹⁸ Ne fakt krijimi i ketyre keshillave (*te cilat do gjykonin ankimet dhe protestat si shkalle e dyte, me perjashtim te atyre geshtjeve qe ishin ne kompetence te Gjykates se Larte*) erdhi si shkak dhe domosdoshmeri i ketyre ndryshimeve strukturore. Kalimi i te gjitha ceshtjeve, per te cilat ishte dhene vendim nga gjykatat e rretheve dhe qe ankimoheshin direkt ne Gjykatën e Larte (*tashme si shkalle e dyte ne sistemin gjyqesor te kohes*), solli nje “mbingarkese” te kesaj gjykate, si organi me i larte i gjyqesorit, duke veshtriresuar aktivitetin e saj dhe duke kufizuar mundesine qe te luante rolin e saj te zakonshem ne drejtim te nxjerrjes se udhezimeve per sistemimin dhe orientimin e praktikës gjyqesore.

Mund te evidentohet se karakteristike e kohes, qe vinte edhe si rezultat i ideologjise qe vihej ne zbatim ne ate periudhe qe shoqeroi efektet e ligjit te ri, ishte mungesa dhe ulja e nivelit te dhenies se drejtesise ne menyre profesionale. Kjo gje mund te shihet qarte nga permbajtja e dispozitave ne nenin 9, 10 te ketij ligji. Tentativat e vazhdueshme per te afruar gjyqesorin me masat popullore perbenin nje prej goditjeve qe iu dha profesionalizmit ne dhenien e drejtesise, pavaresisht menyres se prezantimit te ketij ligji si nje ligj me karakter demokratik.

Shqiperia u quajt Republika Popullore Socialiste e Shqiperise dhe forma e qeverisjes ishte diktature proletariati. Duke qene se filloi nje tradite e re qeverisese edhe perpunimi i legjislacionit duhet te fillonte nga e para. Kod Civil te mirfillte pati ne 1981 me miratimin e tij me ligjin Nr.6340, datë 26.6.1981 nga Prestidiumi i Kuvendit Popullor te RPSSH .

Kodi ndahej ne dy pjese ne ate te pergjithshmen dhe te posatcmen.

Legjislacioni civil i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, ishte shprehese i vullnetit te klasës punëtore të organizuar në shtetin e diktaturës së proletariatit. Ky legjislacion rregullonte marrëdhëniet pasurore, si edhe marrëdhëniet personale jopasurore ndërmjet ndërmarrjeve, institucioneve, kooperativave bujqësore, organizatave shoqërore, ndërmjet këtyre e shtetasve, si edhe ndërmjet vetë shtetasve.

Nder burimet kryesore te ketij Kodi cilesohj Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Gjithashtu ne kete Kod ndikonin Politika e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe ideologjia e klases punetore te marksizem- leninizmit.

Bibliografia

AQSH

Ardian Nuni, “E drejta civile-Pjesa e përgjithshme”, Tiranë 2009

Baltasar Benussi, *Komentari i Kodit Civil- Sendet Zotenimi dhe modifikimet e tija (Libri i III I KC)*; Botim i Ministrise se Drejtesise; Tirane, 1931

Bernd J. Fischer, *Mbreti Zog dhe perpjekja e tij per stabilitet*; Shtepia Botuese “Cabej”; Tirane

2004 Juliana Latifi, “E drejta civile - pjesa e përgjithshme” Tiranë 200

Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912- 2005*; Shtepia Botuese 55

Koco Nova, “Zhvillimi i Organizimit gjyqesor ne Shqiperi” Univeristet i Tiranes 1982

Mariana Semini, “ E Drejtë Civile. Pjesa e Përgjithshme. Subjektet” Fakulteti i Drejtësisë “Justicia” Tirane

2004 Valentina Kondili “ E Drejte Civile. Pjesa e përgjithshme” Tirane 2007

Historia e shtetit dhe e se drejtes ne Shqiperi; Luarasi University Press, Tirane

2007 Historia e Gjykatave Shqiptare, Tirana 2000

Kodi Civil 1929 (Mbretëria Shqiptare - Ministria e Drejtesis); Shtepia Botuese Papirus, 2010

Kodi Civil i Republikës se Shqiperise (me ndryshimet perkatese); AlbJuris, Tirane 2012

Kodi Civil i Republikës Popullore Socialiste Shqiptare; Qendra e Botimeve Zyrtare, Tirane 1981

Dekretin nr. 5107, dt. 30.10.1973 “Mbi krijimin e keshillit gjyqesor ne gjykata e rretheve dhe disa ndryshime ne kompetencat e gjykatave.” Koco Nova, vep e cit., fq. 139

HISTORIA E SË DREJTËS PENALE NË SHQIPËRI

DR. ÇLIRIM DURO

ABSTRAKT

Kumtesa e historisë së të drejtës penale në periudhën shek XII shek. XX (vitet 1990) na jep një informacion të përgjithshme për zhvillimin e rolit e saj në realizimin e funksionimit të saj mbrojtës, i cili nuk ka qenë i njëjlojtë kudo e kurdoherë. Megjithatë studimi i historisë së të drejtës penale paraqet jo vetëm rendin historik, por edhe aktual, sepse shërben si model për të arritur edhe e drejta jonë penale në standardet evropiane. Pikërisht për këtë arsye kumtesa e paraqitur është përqendruar në paraqitjen e historikut të legjislacionit penal dhe mendimit teorik (shkollat kryesore) të së drejtës penale të shqiperise nga Bizanti deri ne vitet 90. Historia e së drejtës penale të Shqipërisë, është zhvilluar më e zgjeruar, duke përfshirë historinë e periudhës ku Shqipëria ishte pjese e Perandorisë Bizantine deri në vitet nëntë-dhjetë te shekullit njëzetë. Kjo kumtesë mendoj se u shërben juristëve dhe të tjerë, për të rritur nivelin e tyre kulturor e juridik dhe për realizimin me cilësi të lartë të drejtësisë penale në praktikë.

Fjalë kyç: *E drejtë penale, historia, efektivitet, legjislacioni*

Drejtësia penale në territorin e Shqipërisë në periudhën para vitit 1912

Sistemi gjyqësor penal në Shqipëri është krijuar në një kohë të vonshme që gjien fillimet e tij pas shpalljes së pavarësisë dhe krijimit të shtetit shqiptar. Përpara kësaj periudhe në territoret e banuara nga shqiptarë dhënia e drejtësisë është bazuar kryesisht në rregullat dhe normat ligjore që ekzistonin në shtetet të cilat kanë mbajtur të pushtuara hapësirat territoriale të banuara nga shqiptarë. Po kështu, gjatë kësaj periudhë kanë gjetur zbatim e drejta kishtarë, si dhe e drejta zakonore.

Në periudhën e vendosjes së sundimit bizantin në tokat shqiptare, deri në shekullin XII, territoret shqiptare ishin të ndarë në dy “thema”, që ishin njësi administrative të hallkës më të lartë, “thema e Durrësit” dhe “thema e Prevezes”¹. Në krye të kësaj njësie qëndronte “strategu”, i cili ishte mbajtësi i pushtetit më të lartë në themë dhe përveç se ushtronte pushtetin politik dhe ushtarak, ai ushtronte edhe pushtetin në fushën e dhënies së drejtësisë². Më pas u krijuan institucione të reja në themë, midis të cilave dhe “gjyqtari i themës”, i cili ushtronte funksionin e dhënies së drejtësisë.

Në periudhën e principatave shqiptare nga shekulli XII-XV e drejta pozitive përbëhej nga normat juridike të pushtetit qëndror, por që gjente zbatim edhe e drejta kishtarë (kanonike) dhe ajo zakonore. Kisha në këtë periudhë përveç ushtrimit të kultit ushtronte edhe kompetenca të caktuara në fushën e së drejtës penale. Në kompetencat gjyqësore të kishës përfshihej gjykimi i klerikëve për cdo vepër penale të kryer prej tyre, pavarësisht nëse kishte ose jo lidhje me ushtrimin e kultit fetar, por mjaftonte që subjekti të ishte klerik. Gjithashtu, në kompetencat gjyqësore të kishës përfshiheshin edhe kompetencat për gjykimin e personave laik, në rastet kur këta kryenin vepra penale që drejtoheshin kundër doktrinës fetare, herezitet, krimet kundër familjes dhe martesës, rrëmbimi i vajzave, marrëdhëniet seksuale me dhunë etj³.

Po në këtë periudhë mesjetare në procedurën penale zbatoheshin torturat si dhe të ashtuquajturat “gjyqe të zotit”, në rastet kur mungonin provat e tjera. Në këtë rast barra e provës i takonte të akuzuarit. Për të provuar pafajësinë e tij, i pandehuri duhej që të kapte me dorë një hekur të skuqur, fë fuste dorën në ujë të valuar dhe veprime të tjera të kësaj natyre. Në rast se i akuzuari për kryerjen e veprës penale arrinte që të duronte këto prova mbinjerëzore, atëherë ai fitonte pafajësinë, në rast të kundërt konsiderohej fajtor dhe dënohej. “Gjyqet e zotit” ishte mjete represioni ndaj masave të punonjësve dhe shërbenin edhe si një mekanizëm mesjetar të përdorur gjerësisht në Europën feudale për të dënuar të akuzuarit edhe atëherë kur mungonin provat më elementare. Ndërkohë këto lloj gjyqesh nuk përdoreshin ndaj klerikëve, si dhe përdoreshin rrallë ndaj fisnikëve⁴.

Funksionet e dhënies së drejtësisë penale në këtë periudhë kryheshin nga gjykatësit e qytetit, të cilët zgjidheshin cdo vit nga mbledhja e popullit, që ishte organi më i lartë i qeverisjes së qytetit, ose nga këshilli i madh. Zakonisht ishin katër gjykatës, por numëri i tyre ishte i ndryshueshëm. Në kompetencat e gjykatësve të qytetit ishin çështjet civile dhe ato penale, përveç atyre që iu përkisnin gjyqit të kishës. Gjatë sundimit venecian kompetencat e gjykatësve të qytetit u kufizuan së tepërmi, dhe kompetencat më të rëndësishme gjyqësore iu kaluan rektorëve të Republikës. Gjykimi zhvillohej në dy shkallë dhe njihej e drejta e ankimit kundër vendimeve gjyqësore. Ankimi kundër vendimeve të gjykatësve të qytetit bëhej tek rektori i Shkodrës, ndërsa për çështjet që gjykonte vetë rektori në shkallë të parë ankimi bëhej në Venetiks⁵.

Me mbledhjen më datë 02.03.1444 të kuvendit të përgjithshëm kombëtar, i njohur si Kuvendi i Lezhës, u krijua Lidhja e Lezhës nën udhëheqjen e Gj.K.Skënderbeut. Skënderbeu përveç funksioneve të tij si kryetar i lidhjes vec të tjerave ushtronte edhe funksione gjyqësore, sic ishin dënimet për krime të rënda kundër shtetit, si tradhëtitë, spiunazhi etj⁶. Bujarët feudale i gjykonte dhe i dënonte Skënderbeu. Nuk ka ndonjë të dhënë konkrete për këtë periudhë lidhur me mënyrën e gjykimit dhe dënimin të fshatarëve të varur nga bujari feudal. Në principatat feudale shqiptare ata gjykoreshin dhe dënoheshin nga bujarët e vecantë, të cilët ishin sundimtarë dhe gjykatës të tyre. Me krijimin e shtetit të përqëndruar shqiptar këto forma të vjetra të organizimit gjyqësor duhet të kenë ndryshuar, duke kaluar e drejta e gjykimit të tyre në dorë të qeveritarëve të Skënderbeut, që ndesheshin me emrat guvernatori, officiali, magistrat etj, por nuk mund të flitet për përmbytjen e saktë të funksioneve të tyre shtetërore⁷.

Pas vdekjes së Skënderbeut territoret shqiptare ranë përsëri nën sundimin osman, i cili vazhdoi që të ekzistonte për disa shekuj deri në shpalljen e pavarësisë në vitin 1912. Kështu që, duke qënë pjesë e perandorisë osmane, në Shqipëri gjente zbatim e drejta osmane dhe funksionin institucionet e perandorisë osmane.

E drejta osmane që zbatohet gjatë periudhës së pushtimit osman dallohet për karakterin e saj tepër të ashpër. Fajtorët në këtë periudhë mund të dënoheshin me prerje të ndonjë nga organet ose të ndonjë nga pjesët e trupit. Për veprime të tilla si mohimi i fesë, fyerja e profetit apo e fesë, dënoheshin me vdekje. Marrëdhëniet jashtëmartesore dënoheshin me vdekje që kryhej duke goditur me gurë të dënuarin deri në vdekjen e tij, vjedhja dënohej me prerjen e dorës së djathtë.

Kadiu ishte funksionari i ngarkuar për realizimin e drejtësisë në emër të sulltanit, si dhe konsiderohej si gjyqtari më i lartë. Kadiu emërohej, shkarkohej dhe transferohej nga sulltani, dhe caktoheshin në qendra të populluara ose me juridiksion të gjerë. Kadiu kishte kompetenca të gjera në gjykimet e çështjeve penale si dhe në ato civile. Ai vendoste për masën dhe llojin e dënimin, me përjashtim të krimeve të rënda për të cilat dënimi ishte parashikuar në ligji i shenjtës.

Historia e Shtetit dhe e se Drejtes ne Shqiperi, shtepia botuese “Luarasi”, faqe 81.

Po aty.

Historia e Shtetit dhe e se Drejtes ne Shqiperi, shtepia botuese “Luarasi”, faqe 125-126.

Po aty, faqe 119.

Historia e Shtetit dhe e se Drejtes ne Shqiperi, shtepia botuese “Luarasi”, faqe 138.

Historia e Shtetit dhe e se Drejtes ne Shqiperi, shtepia botuese “Luarasi”, faqe 176.

Po aty, faqe 216-217.

Historia e Shtetit dhe e se Drejtes ne Shqiperi, shtepia botuese “Luarasi”, faqe 253.

Shqyrtimi i çështjeve penale dhe civile bëhej para kadiut, i cili vepronte si gjyqtar i vetëm. Nuk i jepej rëndësi formës procedurale të zhvillimit të gjykimit dhe për këtë arsye nuk ekzistonte ligj që të rregullonte procedurën e gjykimit. Madje nuk ekzistonte ndonjë dallim midis zhvillimit të gjykimit të një çështje civile dhe gjykimit të një çështje penale. Kadiu iu përmbahej disa rregullave elementare që lidheshin me formulimin e kërkesave dhe të pretendimeve të palëve, që lidheshin me provat që duhej të paraqiteshin nga të interesuarit. Nuk ekzistonin afate lidhur me kryerjen e veprimeve procedurale por kadiu kishte për detyrë që të përpiqej për të përfunduar gjykimin e çështjeve brënda një seance të vetme.

Gjykimet zhvilloheshin në territorin e xhamisë. Gjatë gjykimi fillimisht akuzuesi formulonte para kadiut kërkesën e tij dhe pas kësaj kadiu pyeste të akuzuarin nëse e pranonte akuzën që i bëhej. Nëse ky i fundit e pranonte akuzën, i jepej fund procesit dhe kadiu vendoste dënimin duke dëgjuar edhe kërkesën e akuzesit. Nëse i akuzuari nuk pranonte akuzën kadiu urdhëronte paraqitjen e provave për të provuar akuzën. Akuza mundej të provohej me pohimin, dëshminë dhe benë. Për të provuar veprat penale nevojiteshin dy dëshmitarë meshkuj, ndërsa për të provuar lloje të vecanta të veprave penale ishin të nevojshëm katër dëshmitarë. Beja ishte ishte afirmimi i një fakti duke përmëndur në seancë emrin e Allahut para kadiut⁹.

Procesi penal sipas ligjit të shenjtë kishte tipare të procedurës sipas sistemit akuzator si dhe sistemit inkuizitor. Kadiu nuk kishte rol aktiv, por e zgjidhte çështjen në bazë të provave të paraqitura nga palët. Në cmuarjen e provave, megjithëse në procedurën e ligjit të shenjtë kishte disa karakteristika të sistemit të provave formale, kadiu kishte mundësi të shumta për të vepruar sipas bindjes së tij, dhe njëkohësisht nuk ishte i detyruar që të arsyetonte me hollësi bindjen e krijuar.

Gjatë sundimit osman për shkak të rënies së vazhdueshme të fuqisë osmane dhe dobësisë të kontrollit të saj në territoret shqiptare familje më të forta feudale krijuan pashallëqet, të cilat ishin njësi administrative të perandorisë dhe udhëheqësit e këtyre njësive kishin fituar titullin e pashës. Nga pashallëqet e krijuara në vëndin tonë më të rëndësishmit ishin pashallëku i Shkodrës dhe ai i Janinës.

Në pashallëqet e Shkodrës dhe të Janinës përgjithësisht vazhdoi që të vepronte legjislacioni i përgjithshëm që vepronte në të gjithë perandorinë osmane, kështu që organizimi i drejtësisë edhe në këtë kohë nuk u ndryshua. Megjithatë, Ali Pasha si sundimtar i pashallëkut të Janinës rishikonte kryesisht ose me kërkesën e të interesuarve vendimet e gjykatave të pashallëkut të tij, ai shqyrtonte dhe zgjidhte vetë çështjet penale në shkallë të parë dhe të fundit.

Përveç kadiut ose gjyqtarit të vetëm, në pashallëkun e Janinës funksione të drejtësisë penale ushtronte edhe pleqësia e fshatrave dhe të komuniteteve, për çështje penale që lidheshin me krime të lehta. Pleqësia zbatonte jo vetëm ligjet në fuqi por edhe zakonet e vëndit. Po kështu, gjatë pashallëkut të Janinës ushtronin funksione gjyqësore edhe gjykatat e vecanta të disa qyteteve autonome si dhe pleqësitë e disa fshatrave autonome¹⁰.

Në Shqipëri në periudhën në fjalë në dhënien e drejtësisë penale ka gjetur zbatim edhe e drejta zakonore, e cila përveç të tjerave parashikonte rregulla të vecanta për hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale dhe atyre civile.

Kështu, kanuni i Lekë Dukagjinit dhe kanuni i Labërisë parashikonin norma për mënyrën e hetimit të çështjeve penale nga vetë i dëmtuari, nga pleqtë e zakonit, apo me anë të kallëzuesit (kapucarit). Në kanunin e Lekë Dukagjinit përmëndet hetimi i pleqve, një vënd të posacëm në përjashtimin nga përgjegjësia zinte “beja”, parashikohej mënyrat dhe format e “besë”. Në të njëjtën mënyrë parashikoheshin të tilla rregulla edhe në kanunin e Labërisë. Jo më pak rëndësi kishte zbulimi i gjurmës, e cila kur të conte deri të shtëpia, personi duhej që të deklarohej fajtor dhe të përgjigjej penalisht, ndërsa kur gjurma e personit që kishte kryer një vepër penale të conte deri në kufi të fshatit, atëherë përgjigjej fshati, i cili detyrohej që të gjente fajtorin¹¹.

Sipas këtyre kanuneve gjykimi i çështjeve realizohej nga gjyqi i pleqve, i cili krijohej për cdo çështje konkrete. Gjatë gjykimit palët nuk merrnin pjesë, por ankimet dhe pretendimet e tyre ata i paraqitnin paraprakisht pleqve të zgjedhur dhe secila palë më vete. Pleqtë që gjykonin çështjen mundej që të thërrisnin dhe të pyesnin dëshmitarët që kishin dijeni për çështjen që gjykohej. Vendimi i pleqve ekzekutohej vullnetarisht. Në kanunin e Lekë Dukagjinit parashikohej që kundër vendimit të gjyqit të pleqve mundej të bëhej ankim, pranohej Dera e Gjonmarkut si shkalla më e lartë për dënimin me vdekje, kurse në kanunin e Labërisë si shkalla më e lartë e gjyqit ishte gjyqi i pleqve të krahinës.

Sistemit gjyqësor penal në periudhën 1912-1939.

Në vështrimin historik që i bëhet sistemit gjyqësor penal në Shqipëri hapi i parë në të cilin shënohet krijimi i Institucioneve të shtetit shqiptar është periudha e viteve 1913-1920. Pas shpalljes së pavarësisë së shtetit shqiptar në vitin 1912, fillimisht duke u nisur edhe nga rrethanat historike dhe politike në të cilat filluan që të krijoheshin Institucionet shtetërore të asaj kohe, të cilat diktonin nevoja të rëndësishme në drejtim të krijimit dhe organizimit të shtetit të sapokrijuar, Qeveria e Përkohshme e Vlorës në fushën penale la në fuqi legjislacionin penal ekzistues osman, si lidhur me të drejtën materiale penale ashtu edhe lidhur me të drejtën procedurale penale. Megjithatë, krahas krijimit të Institucioneve shtetërore Qeveria e sapokrijuar e asaj kohe brënda një periudhe të shkurtër ndërmori masa për të riorganizuar sistemin e drejtësisë penale të shtetit të ri shqiptar. Në këtë drejtim shënon një hap të rëndësishëm miratimi në datën 10 Maj të vitit 1913 të “Kanunit të Zhurisë”. Data e miratimit të këtij akti 10 Maji, njihet zyrtarisht në Shqipëri si “Dita e Drejtësisë”.

“Kanuni i Zhurisë” parashikonte krijimin e “Gjykatës së Diktimit” dhe gjithashtu parashikonte krijimin edhe të Gjykatave të

shkallës së parë të nënprefekturave, të cilat kishin në kompetencë gjykimin e çështjeve civile si dhe të çështjeve penale. Po

Po aty, faqe 254.

Historia e Shtetit dhe e se Drejtes ne Shqiperi, shtepia botuese “Luarasi”, faqe 281.

Ngasimet kryesore midis Kanunit të Lekë Dukagjinit dhe Kanunit të Labërisë, Revista Jeta Juridike nr.2 Shkurt 2004, Artikull, Ismet Elezi,

kështu, parashikohej krijimi i Gjykatës me Juri, ku përfaqësues të popullit merrnin pjesë në gjykimin çështjeve penale. Në fakt, kjo Gjykatë është vënë në jetë vetëm një herë në Elbasan dhe duke qënë se nuk dha rezultatet që priteshin u anulua krijimi i kësaj Gjykate me dekretin e datës 4 qershor të vitit 1914¹².

Për shkak të rrethanave historike Qeveria e Përkohshme e Vlorë e krijuar në vitin 1912 dha dorëheqjen, kështu që krijimi i sistemit të drejtësisë penale në atë kohe ngeli në fazën fillestare të tij.

Gjatë qeverisjes së Princ Vedit në Shqipëri, më datë 4 qershor të vitit 1914, doli dekreti i ri për organizimin e sistemit gjyqësor. Sipas tij u krijuan; Këshilli i Pleqve, Gjyqi i Paqit, Gjykata e Shkallës së Parë, Gjyqi i Apelit dhe Gjykata e Diktimit. Por, edhe ky dekret për shkak të fillimit të Luftës së Parë Botërore ngeli i pazbatuar¹³.

Në vitet në vazhdim nga viti 1920 deri në vitin 1939 ishte e nevojshme riorganizimi i Institucioneve gjyqësore, si dhe njëkohësisht kualifikimi i personave që do të ushtronin funksionet e tyre në këto Institucione. Në fakt, hapi i parë ishte hedhur me Kanunin e Zhurisë, por në vitet “20 filloi që të kristalizohej më mirë organizimi dhe funksionimi i sistemit gjyqësor.

Pas Kongresit të Lushnjes, me dekretin e Këshillit të Naltë të datës 11.01.1921, u krijuar sistemi gjyqësor, i cili përfshinte 18 Gjykata Paqtuese, 7 Gjykata të Shkallës së Parë nëpër prefektura, si dhe një Gjykatë Diktimit me qendër në Shkodër. Ky sistem u ndryshua me ligjin e datës 27.01.1923, i cili parashikonte Gjykatat Paqtuese, Gjykatat Filllore dhe Gjykatën e Diktimit me qendër në Tiranë. Në këtë ligj u shpallën parimet demokratike për emërimin dhe patundshmërinë e gjyqtarëve, për sigurimin e së drejtës së mbrojtjes, si dhe për karakterin publik të gjykimin¹⁴.

Me Dekretin datë 02.05.1925, për Organizimin e Gjykatave të Drejtësisë, sistemi gjyqësor penal pësoi përsëri ndryshime. Gjykatat ishin organizuar në Gjykatat e Shkallës së Parë, që ngriheshin në qendrën e cdo nënprefekturë, Gjykatat e Apelit, që ngriheshin në cdo prefekturë, si dhe Gjykata e Diktimit (Gjykata e Lartë) e cila e cila kishte qendrën në Tiranë.

Gjykata e Diktimit ishte e ndarë në dhomën civile dhe në dhomën penale. Cdo dhomë kishte një Kryetar, katër anëtarë, një asistent, si dhe një numër sekretarësh. Pranë Gjykatës së Diktimit ishte vendosur Prokurori, si dhe një asistent i Prokurorit. Secili nga Kryetarët e dhomave të Gjykatës së Diktimit drejtonte dhomën e tij përkatëse, por në rastet kur dhomat mbledheshin së bashku pozicioni i Kryetarit i përkiste Kryetarit të dhomës civile. Gjatë periudhës kohore nga viti 1920 deri në vitin 1940 Gjykata e Diktimit njihet për vendime që tregonin një profesionalizëm të lartë, si dhe për organizimin e proceseve të rregullta gjyqësore. Në vendimet e Gjykatës së Diktimit të kësaj periudhe janë vënë re cilësi e lartë dhe argumentime shkencore të dënimeve të dhëna nga kjo Gjykatë¹⁵.

Në vitin 1927 dhe në vitin 1929 u bënë ndryshime të tjera në organizimin e sistemit të drejtësisë penale, të cilat përmirësuar më tej organizimin gjyqësor të kësaj periudhe. Jo vetëm në fushën penale por edhe në atë civile Shqipëria në këtë periudhë në hartimin dhe miratimin e akteve ligjore u mbështet kryesisht në legjislacionin Italian dhe në atë Francez, duke krijuar kështu një kuadër ligjor bashkëkohor dhe që arrinte të plotësonte nevojat normative në atë kohë për krijimin e një sistemi të mirëfilltë gjyqësor penal.

U njohën në këtë periudhë edhe gjykimet e posacme në fushën penale, si gjykimi i drejtëpërdrejtë dhe ai me dekret penal. Gjykimi i drejtëpërdrejtë zbatohet për faje flagrante, ndërsa ai me dekret penal për delikte dhe kundravajtje të lehta që dënoheshin me gjobë ose me burgim deri në një muaj¹⁶.

Sistemit gjyqësor penal në periudhën 1944-1990

Gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore u krijuan gjyqet partizane, që gjykonin tradhëtinë, dezertimin, placktijën, vrasjen, vjedhjen, si dhe krimet e drejtuara kundër Luftës Nacional Clirimtare. Këto gjyqe nuk gjykonin me ndonjë procedurë të caktuar, por zbatonin udhëzimet e lëshuara nga komandat ushtarake. Më 16.11.1944 Komanda e Përgjithshme e UNÇ miratoi rregulloren për funksionimin e gjyqeve ushtarake. Sipas saj gjyqi nuk ishte i lidhur me provat, por jepej vendimi sipas gjykimin të lire. Vendimet ishin të paankimueshme, por në rastet e dënimit me vdekje çështja i dërgohej Gjyqit të Lartë Ushtarak. Ndërkohë gjyqet ushtarake shqyrtonin në këtë periudhë edhe disa krime të kryera nga civilët¹⁷.

Me ligjin nr.59 datë 17.05.1945 “Për organizimin e përkohshëm gjyqësor” u krijuan Gjykatat e zakonëshme. Ato u quajtën gjykata popullore, në përbërjen e të cilave kishte gjyqtarë profesionistë dhe gjyqtarë të zgjedhur nga këshillat popullore të nënprefekturave dhe të prefekturave. Gjykatat e nënprefekturave gjykonin me një gjyqtar profesionist dhe dy gjyqtar popullorë, gjykatat e prefekturave gjykonin me dy gjyqtar profesionistë dhe një gjyqtar popullor, ndërsa Gjykata e Lartë përbëhej nga 8 deri në 10 gjyqtarë dhe ndahej në dy seksione dhe një këshill të përgjithshëm¹⁸.

Me miratimin e Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë të vitit 1946, si dhe ligjit nr.1284 datë 09.06.1951 u riorganizua përsëri sistemi gjyqësor penal në Shqipëri. Drejtësia jepej nga Gjykata e Lartë, nga gjykatat popullore dhe nga gjykatat ushtarake¹⁹. Juridiksioni i gjykatave ushtarake u kufizua me krimet me karakter ushtarak dhe ato të kryera nga

Historia e Gjykatave Shqiptare, Tirana 2000, f.43.

¹³ Vështrim i shkurtër historik i drejtësisë penale në Shqipëri dhe sfiadat Ismet Elezi.

Procedura Penale, Komentar, H.Islami, I.Panda, A.Hoxha, faqe 11.

Supreme Court of Albania, from Wikipedia, the free encyclopedia, www.Wikipedia.com.

Procedura Penale, Komentar, H.Islami, I.Panda, A.Hoxha, faqe 11.

Procedura Penale, Komentar, H.Islami, I.Panda, A.Hoxha, faqe 12, 13.

Procedura Penale, Komentar, H.Islami, I.Panda, A.Hoxha, faqe 13.

Neni 79 i Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë.

para saj, Revista Shkencore “Justiniani I”, nr.1, dhjetor 2009,

ushtarakët. Gjyqtarët e gjykatave popullore dhe ndihmësgjyqtarët në këtë periudhë zgjidheshin nga populli dhe gjyqtarët e zgjedhur mund të revokoheshin, ndërsa Gjykata e Lartë zgjidhej nga Kuvendi Popullor për katër vjet²⁰.

Ligji për organizimin e sistemit gjyqësor i vitit 1951 e ndante Gjykatën e Lartë në disa kolegje gjyqësore; kolegji penal, kolegji civil, kolegji ushtarak, kolegji disiplinor. Cdo kolegji gjykonte çështjet penale në kompetencën e tij materiale me një panel të përbërë nga Kryetari, një anëtar i Gjykatës së Lartë dhe dy asistentë. Po kështu, Gjykata e Lartë gjykonte në raste të vecanta edhe si Plenium, që përbëhej nga Kryetari, zëvendëskryetari, si dhe të gjithë anëtarët e Gjykatës së Lartë.

Vendimet e Pleniumit të Gjykatës së Lartë, ashtu si dhe gjithë mendimi juridik në këtë periudhë ishin të ndikuara nga ideologjia dhe politika që ndiqte sistemi komunist. Në vecanti këto influenca ideologjike dhe politike ndikuan seriozisht edhe në aspektin penal, me anë të interpretimeve të gjera të ligjit penal. Unifikimet e praktikës gjyqësore të bëra nga Pleniumet e Gjykatës së Lartë shërbenin për të orientuar gjykatat e niveleve më të ulëta, në mënyrë që ato të mund të gjykonin çështjet në përputhje me politikën, ideologjinë dhe legjislacionin e shtetit diktatorial.

Me ligjin nr.4406 dt.24.06.1968 “Për organizimin gjyqësor në Republikën Popullore të Shqipërisë”, u ndryshua përsëri struktura e organeve gjyqësore. Në bazë të tij drejtësia jepej nga Gjykata e Lartë, gjykatat e rretheve, gjykatat e fshatrave, gjykatat e qyteteve si dhe të lagjeve të qyteteve. Me këtë ligj gjykatat e qarqeve u suprimuan dhe gjykimi i shkallës së dytë u përqëndrua në Gjykatën e Lartë. Gjithashtu, u suprimuan edhe gjykatat ushtarake dhe u zëvendësuan me kolegjet ushtarake pranë gjykatave të rretheve. Gjykatat e fshatrave, të qyteteve dhe të lagjeve të qyteteve, u ngarkuan për të gjykuar vepra penale me rëndësi të vogël e të thjeshta. Ky sistem u ndryshua përsëri me dekretin nr.5107 datë 30.10.1973, me të cilin u krijuan këshillat gjyqësor në gjykatat e rretheve, që përbëheshin nga gjyqtarët e rrethit dhe gjykonin në shkallë të dytë çështjet penale që gjykonin kolegjet e tyre në të njëjtën gjykatë²¹.

Më vonë me dekretin nr.7177 dt.20.11.1987 iu bënë përsëri ndryshime sistemit gjyqësor penal, ku këshillat gjyqësor që funksiononin pranë gjykatave të rretheve u zëvendësuan me gjykatat e zonave, të cilat gjykonin si shkallë e dytë, dhe për disa çështje gjykonin si shkallë e parë, si çështjet të caktuara nga Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe çështjet e prishura për të dytën herë²².

Sistemit gjyqësor penal në periudhën pas viti 1991

Me ndryshimet politike të vitit 1990 dhe me instalimin e pluralizmit politik në Shqipëri, ishte e domosdoshme një reformim rrënjësor i sistemit gjyqësor në tërësi dhe jo vetëm atij penal. Në këto rrethana një hap me rëndësi ishte miratimi në vitin 1991 i ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, akt i cili shfuqizonte Kushtetutën e vitit 1976, formonte bazat juridike për krijimin e sistemit të ri gjyqësor penal, si dhe shërbente si bazë juridike për reformimin e sistemit të drejtësisë penale në tërësi.

Me ligjin nr.7574 datë 24.06.1992 “Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në kodet e procedurave penale e civile”, duke u ndryshuar sistemi gjyqësor ekzistues i para viteve 1990, parashikohej krijimi i Gjykatës së Kasacionit dhe gjykatave të apelit, përcaktohej funksionimi dhe kompetencat e tyre në përputhje me standartet ndërkombëtare.

Mbi bazën e ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese” të vitit 1991 u miratua me ligjin nr.7895 datë 27.01.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë dhe me ligjin nr.7905 dt.21.03.1995 u miratua Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, akte këto që megjithë ndryshime që kanë pësuar janë ende në fuqi aktualisht.

Në Kushtetutën e vitit 1998, në nenin 135 të saj, është parashikuar që aktualisht pushtetit gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj. Anëtarët e Gjykatës së Lartë emerohen nga Presidenti me pëlqimin e Kuvendit dhe kanë një mandat 9 vjecar pa të drejtë riemërimi. Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Ka juridiksion fillestar për gjykimin e akuzave penale ndaj Presidentit të Republikës, Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të asaj Kushtetuese. Kur përmëndim juridiksion rishikues kemi parasysh jo vetëm kërkesat për rishikimin e vendimeve penale që kanë marrë formë të prerë, por përfshihen edhe gjykimet e çështjeve penale të gjykuara më parë nga gjykatat e apelit dhe nga gjykatat e shkallës së parë. Ndërsa, Gjykata Kushtetuese është jashtë sistemit gjyqësor dhe njëkohësisht e pavarur nga degët e tjera të pushtetit. Gjykata Kushtetuese bën interpretimin përfundimtar dhe garantimin e Kushtetutës.

Me ligjin nr.9877 datë 18.02.2008 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” është përcaktuar mënyra e krijimit, organizimit, kompetencat e gjykatave, kushtet dhe procedurat e emërimit të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. Aktualisht gjykatat e shkallës së parë janë gjykatat e rretheve gjyqësore dhe gjykata e krimeve të rënda²³.

Gjykatat e rretheve gjyqësore funksionojnë në të gjitha rrethet gjyqësore²⁴. Ndarjen e rretheve gjyqësore nuk e ka parashikuar vetë ligji i mësipërm, por kompetencat tokësore të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe qendrat e ushtrimit të veprimtarive të tyre, caktohen me dekret të Presidentit të Republikës²⁵. Gjykatat e apelit ndodhen në gjashtë qarqe dhe gjykojnë çështjet penale në shkallë të dytë. Këto gjykata shqyrtojnë ankime të vendimeve të gjykatës së shkallës së parë në kolegje prej tre

Neni 85 i Kushtetutes se Republikës Popullore të Shqiperise.

Procedura Penale, Komentar, H.Islami, I.Panda, A.Hoxha, faqe 15.

Procedura Penale, Komentar, H.Islami, I.Panda, A.Hoxha, faqe 18.

Neni 4 i ligjit nr.9877 datë 18.02.2008 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Rrethet gjyqësore nuk koresponojnë gjithmonë me emrat e qyteteve. Psh. Bashkia Ersekë bën pjesë në rrethin gjyqësor të Korcës,

Bashkia Librazhd bën pjesë në rrethin gjyqësor Elbasan etj.

Neni 6/3 i ligjit nr.9877 datë 18.02.2008 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

gjyqtarësh dhe mundet të shqyrtojnë çështje fakti si dhe çështje ligji. Më parë kanë funksionuar edhe gjykatat ushtarake por aktualisht këto gjykata nuk ekzistojnë dhe veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal Ushtarak gjykohen nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

Më datë 1 janar të vitit 2004 u krijua edhe Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e cila ka kompetencën në të gjithë territorin e Shqipërisë për të gjykuar kryerjen e veprave penale që janë parashikuar shprehimisht në nenin 75/a të K.Pr. Penale. Kjo gjykatë gjykon me trup gjykues të përbërë nga pesë anëtar. Përveç Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda është krijuar edhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, e cila gjykon në shkallë të dytë vendimet e dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ku edhe kjo gjykon me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë.

Në gjykatat e shkallës së parë gjykohen me një gjyqtar kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, kërkesat për ekzekutimin e vendimeve, kërkesat për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja²⁶. Gjykatat e rretheve gjyqësore gjykojnë me një gjyqtar veprat penale që dënohen me gjobë ose me burgim në maksimum jo më shumë se shtatë vjet burgim. Veprat e tjera penale gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Brënda gjykatave të rretheve gjyqësore funksionojnë edhe seksionet e të miturve, për veprat penale që kryhen nga shtetasit e moshës nga 14 deri në 18 vjec, seksione këto të krijuara me dekret të Presidentit të Republikës.

Bibliografia

Historia e Gjykatave Shqiptare, Tirana 2000

Historia e Shtetit dhe e se Drejtës në Shqipëri, shtëpia botuese “Luarasi” Tirane 2007

Ismet Elezi “Ngjasimet kryesore midis Kanunit të Lekë Dukagjinit dhe Kanunit të Labërisë”, Revista Jeta Juridike nr.2 Shkurt 2004
Ismet Elezi “Veshtrim i shkurter historik i drejtësisë penale në Shqipëri dhe sfidat para saj”, Revista Shkencore “Justiniani I”, nr.1, dhjetor 2009,

Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912- 2005*; Shtëpia Botuese 55

Kodi i procedurës penale Tirane, *Botim i Qendrës së Publikimeve*

Zyrtare, 1995 Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë 1946

Procedura Penale, Komentar, H. Islami, I. Panda, A. Hoxha

Procedura Penale, Komentar, H. Islami, I. Panda, A. Hoxha

Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë 1946

ligjit nr.9877 datë 18.02.2008 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 13 i Kodit të Procedurës Penale.

NDIKIMI I AUDIENCËS NË PLATFORMAT TRADICIONALE NË SHQIPËRI

FATOS SALLIU

PhD (c) në shkencë komunikimi në Universitetin Europian të Tiranës

Lektor i lëndëve "Retorikë" dhe "Njohje me Mediet" në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan.

Gazetar në ABC News. e-mail: tossalliu@gmail.com

ABSTRAKT

Gazetaria qytetare është aktualisht një realitet shqiptar. Trendi lindi dhe po zhvillohet pas përhapjes së internetit dhe teknologjisë dixhitale. Gjatë viteve të fundit janë rritur blogimi, përdorimi masiv i rrjeteve sociale dhe format e komunikimit online. Gazetaria qytetare është më e pavarur se platformat tradicionale. Plotëson vakuumin informativ të medieve profesioniste. Edicionet e lajmeve thyhen shpesh nga ngjarje të dërguara nga qytetarët me anë të mesazheve, fotove, videove dhe komenteve. Të gjitha mediet profesioniste kanë faqet ueb në internet dhe seksione të veçanta të bashkëpunimit me gazetarinë qytetare. Gati çdo ditë, edicionet informative dhe emisionet e posaçme ju referohen rrjeteve sociale dhe formave të tjera të ueb 2.0. Ky është një hulumtim i pari i këtij lloji në Shqipëri. Objektivi është të zbulojë impaktin real që ka gazetaria qytetare në mediet konvencionale. Për këtë qëllim janë përzgjedhur platformat tradicionale që ndërveprojnë me gazetarinë qytetare duke u përqendruar në emisione specifike. Metodologjia u bazua në hulumtime të thelluara duke ju referuar profesorëve, kritikëve dhe eksperiencave botërore. U shfrytëzuan studime krahasimore. Ne tre vite kam studiuar shkallen e penetrimit të internetit dhe medias së lëvizshme në Shqipëri. Korrelacionin që ekziston mes tyre dhe gazetarisë qytetare. Matja e indikatorit kryesor, audiencës, u bazua në analizën e emisione specifike që ndërveprojnë me rrjetet sociale dhe gazetarinë qytetare. U shfrytëzuar të dhënat statistikore nga monitorues të specializuar. U realizuan intervista me drejtorë informacioni, kryeredaktorë, moderatorë, inxhinierë të teknologjisë, pronarë të medieve dhe anketime me qytetarë. U analizuan të dhënat dhe u testuan hipotezat. Tema prezanton përfundime të vlefshme për platformat tradicionale në Shqipëri. Shërben si databas dhe pikënisje për hulumtues të tjerë. Është material i vlefshëm për studentët e shkencave sociale dhe komunikimit.

Fjalë kyç: *Gazetari qytetare, media konvencionale, internet, teknologji dixhitale, lajme "break".*

Hyrje

Interneti dhe teknologjia dixhitale po revolucionarizojnë komunikimin masiv në Shqipëri. Qytetarët janë bërë pjesë e raportimeve në media.

Mediet profesioniste kanë mbajtur peshën kryesore në informim. Por tashmë atyre u duhet që të rishikojnë mënyrën se si kanë operuar më parë.

Gazetaria qytetare është tashmë një realitet shqiptar. Ky trend favorizohet nga përhapja me shpejtësi e internetit, ueb 2.0 dhe medias së lëvizshme. Prezencën e saj e hasim kudo. Ajo po afirmohet gjithnjë e më shumë në rrjetet sociale, në faqet web, në blogje, në gazeta, televizione, radio e çdo mjet të komunikimit masiv.

Akti i një qytetari, apo grupi të qytetarëve, të përfshirë në procesin e mbledhjes, raportimit, analizimit dhe shpërndarjes së lajmeve me anë të teknologjive të reja, kanë si objektiv të vetëm për të siguruar informacion të gjerë, të pavarur dhe relevant që është vendimtar për shoqërinë demokratike.

Për këtë dhe vetëm për këtë avantazh, pavarësinë, por edhe ndërveprimin dhe bashkëveprimin, ajo vazhdon të pëlqehet, të rritet, të kapë audiencën dhe horizonte të reja, të përsoset dhe të ndërgjegjësohet.

Ky trend ka dëshmuar deri më tani se gazetaria qytetare nuk ka si synim të vendosë epërsinë ndaj formave të tjera të komunikimit masiv, por të jetë në harmoni dhe kohezion për të informuar më mirë qytetarin e shoqërisë moderne.

Aktivizmi qytetar shprehu fuqinë në protestat kundër projektit të asgjësimit të helmeve siriane në vendin tonë. Vijoi me lëvizjet kundër devijimit të lumenjve Radika dhe Vjosa dhe po vazhdon me forma të tjera investigative duke dëshmuar se është më e pavarur, se është një medium i ri në përbërje të komunikimit masiv, një formë e re e mesazhit. Ajo sfidoi politikën dhe mediet profesioniste duke u bërë promotore e pjesëmarrjes dhe ndërgjegjes qytetare.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Ky hulumtim ka për qëllim të zbulojë ndikimin real që luan audiencën në platformat profesioniste. Objektivi i studimit është që të evidentojë impaktin e medias qytetare ndaj medieve kombëtare.

Aktualisht të gjitha format e komunikimit masiv kanë faqet e tyre ueb në internet. Evoluimi i softuerëve ka krijuar mundësi që këto faqe të ndërveprojnë me rrjetet sociale si Facebook, Twitter, Instagram, e-bay, Skype, LinkedIn, Flickr, You Tube etj, me blogjet, me linqe që të dërgojnë në site, portale faqe të tjera ueb apo forma të tjera të komunikimit online.

Ndodhur nën jehonën që ka provokuar gazetaria me pjesëmarrje, mundësuar nga zhvillimi i teknologjisë, format tradicionale kanë hapur seksion të veçantë në faqen e tyre me akses në mesazh, audio, foto e video, ku ftojnë qytetarët gazetarë të bashkëpunojnë, të sjellin lajme e të komentojnë thjeshtë dhe me qëllimin e vetëm për të mbajtur të lidhur audiencën. Është pikërisht ky indikator që përcakton ekzistencën e medias. Sepse nga ai varet burimi i të ardhurave, reklamat, mekanizmi që shtyn përpara procesin.

Figura 1 tregon seksionin "Ti raporton" në faqen ueb të Top-Channel

Ardhja e internetit ndryshoi tërësisht dialektikën e llojeve të gazetarisë. Ai ka përmbysur format tradicionale të komunikimit masiv. Karakteristikë e medias masive tw kohëve tw sotme është segmentimi i audiencës. Konsumatorët e saj kanë mundësi të zgjedhin se cilën media preferojnë.

Teknologjia i ka dhënë mundësinë publikut mundësinë të zgjedhë informacionin apo zbavitjen që dëshiron. “Shkurt fuqia ka kaluar nga burimi tek marrësi”.¹

Po gazetaria qytetare çfarë kontributesh ka në këtë realitet të ri?

Tani media tradicionale nuk e gëzon më statusin e të qenit i vetmi burim lajmesh. Për më tepër kur publiku ka me vete aleatë të fuqishëm për tu informuar, median online dhe internetin. Rrjetet sociale dhe format e tjera të ueb 2.0 qëndrojnë në pararojë të këtij trendi.

Dhe media shqiptare nuk ka se si të mos jetë pjesë e rrjedhës globale. Të gjitha format tradicionale ndërthuren me modelet e reja. Mënyra se si bashkëpunojnë i bën humbëse apo të suksesshme.

Eksperiencia e deritanishme dhe rezultatet e këtij studimi këtë dëshmojnë. Pas hutimit të parë që provokoi “stuhia” internet, platformat që ndërveprouan dhe u përshtatën, ndodhen në ditë më të mira. Ato po kapin audiencat që kërkojnë.

Pyetja kërkimore, hipotezat dhe metodologjia

Çfarë impakti real luan audiencia në platformat tradicionale në Shqipëri? Sa ndikon media qytetare ndaj asaj profesioniste?

Gazetaria qytetare është më e pavarur se media profesioniste. Këtë status ja ofron interneti dhe teknologjia. Pavarësisht profesionalizmit, saktësisë, objektivitetit dhe çështjeve që kanë të bëjnë me besimin, qytetarët mund ta informojnë shoqërinë pa qenë nevoja e platformave profesioniste. Media e tyre janë komunikimet online, blogimi, rrjetet sociale, faqet ueb, sitet qytetare etj. Eksperiencia botërore dhe ajo shqiptare ofrojnë shembuj pa fund në këtë drejtim.

Mediumi i ri është fenomen global i lidhur ngushtë me internetin, teknologjinë dixhitale, ueb 2.0 dhe medien e lëvizshme. Gazetaria qytetare nuk mund të ekzistojë pa këto komponentë. Kjo përbën hipotezën e dytë në radhë.

Gazetaria qytetare ka varësi nga interneti dhe teknologjia dixhitale. Ky medium nuk ishte pjesë e komunikimit masiv para ekzistencës së tyre. Por studiuesi Dan Gillmor mendon se ka ekzistuar në forma empirike si p.sh fotografi që kapi vrasjen e John Kenedit.²

Gazetaria qytetare është bërë pjesë e programacioneve. Ajo shpreh dhe mbron interesat e komuniteteve. Nuk ka filtra të fortë kontrolli apo barriera që e pengojnë. Sepse gazetarët qytetarë ndodhen kudo dhe me teknologjinë në përdorim mund të japin të parët lajmin e fundit.

Kuadri teorik

Studimi “Impakti i gazetarisë qytetare ndaj platformave profesioniste në Shqipëri” është kryer duke u mbështetur fillimisht në studime të thelluara shkencore të literaturës së autorëve më të njohur të fushës. Hulumtimi i kuadrit teorik u gërshetua me mendimin kritik. U studiuan përvojat dhe eksperiencat më të spikatura të mediebotërore dhe janë krahasuar me modelin shqiptar të organizatave profesioniste.

Ky studim është bazuar në rezultatet e kërkimeve bashkëkohore të profesorëve dhe studiuesve më në zë sot në fushën e gazetarisë qytetare dhe ueb 2.0. Mes tyre përmend Dan Gillmor, Nic Newman, Joseph D.Lasica, Sonia Livingstone, Courtney Radsch, Jay Rosen dhe Jeff Jarvis.

Në këtë studim kam bashkëpunuar me prof. Dan Gillmor autor i njohur ndërkombëtarisht, studiues dhe udhëheqës i mediebotërore, gazetarisë qytetare dhe teknologjisë dixhitale. Ai është drejtor i Knight Center for Digital Media Entrepreneurship at Arizona State University»s Walter Cronkite School of Journalism and Mass Communication dhe bashkëpunor në Berkman Center for Internet & Society at Harvard University.

Monitorimet e emisioneve dhe programacioneve

Impakti i gazetarisë qytetare ndaj platformave profesioniste në Shqipëri përbën rast studimor. Për të provuar këtë ndikim u morën në studim televizionet e rëndësishme kombëtare dhe posaçërisht emisione të spikatura të këtyre platformave. Në Tv Klan u monitorua emisioni “Opinion” i gazetarit të njohur Blendi Fevziu, në Top-Channel u mor në studim emisioni “Top-Story” i gazetarit Sokol Balla.

Për të provuar impaktin gjithë ditë në këto platforma u monitoruan edhe emisionet e mëngjesit “Koha për tu Zgjuar” i moderatorit Bashkim Hoxha në Tv News 24, “Aldo Morning Show” në Tv Klan me moderator Aldon Lipe, si dhe emisioni “Wake Up” i moderatorit Eno Popi në Top-Channel.

U përzgjedhën këto raste pasi bashkëveprojnë me rrjetet sociale dhe gazetarinë qytetare. Është pikërisht ky synimi i studimit; sa i ka impaktuar këto emisione media qytetare?

Ajo që i bën të krahasueshme këto emisione është pikërisht fakti se që të gjithë realizojnë lidhje direkte me qytetarët, lidhje që mundësohen ose nga telefonia fikse, telefonia mobile, interneti apo rrjetet sociale.

Dominic J. Dinamika e komunikimit masiv, UET Press, f. 60.

Gillmor, D. intervistë me autorin

Emisionet e mbrëmjes “Opinion” dhe “Top Story” kanë si veçanti se ndërthuren më shumë me rrjetet sociale facebook dhe twitter, instagram. Ndër to facebook mbetet më i frekuentuari.

Për të mësuar pjesëmarrjen e qytetarëve në emision janë regjistruar ose numëruar telefonatat. Janë pyetur moderatorët se si e bëjnë përzgjedhjen, sa telefonues përzgjedhin. Monitorues të tillë të specializuar si Monitor apo Telematrix mundësuan matjen e audiencës në kohë reale në nivel kombëtar për këto emisione. Faqet në rrjetet sociale tregojnë direkt se sa është numri i qytetarëve që pëlqejnë, komentojnë apo shpërndajnë statuset.

Ky studim nuk mund të kuptohet pa vetë ata, qytetarët gazetarë. Në harkun kohor të dy viteve (2013-2015) qytetarët u anketuan në dy forma; nëpërmjet zgjedhjes rastësore dhe zgjedhjes së qëllimshme të atyre që janë më aktivë në çdo emision në murin e faqes në facebook të “Opinion” apo “Top Story”. Atyre ju drejtuan të njëjtat pyetje në telefon, me pyetësorë të printuar dhe online. Gazeta Info Elbasani çeli një anketim të posaçëm për të matur impaktin që ka gazetaria qytetare në mediat profesioniste.

Disa nga pyetjet e drejtuara qytetarëve ishin nëse i kishin përdorur celularin apo internetin për të njoftuar mediet për ngjarje ku kanë qenë prezentë? Nëse janë bërë pjesë e lajmeve apo emisioneve televizivë me anë të rrjeteve sociale apo lidhjeve telefonike? Përse ndërveprojnë me këto emisione? Nëse ndjekin më shumë mediat online apo mediat profesioniste? Nëse pëlqejnë dhe ndjekin më shumë mediat profesioniste që përfshijnë gazetarinë qytetare? Nëse kanë besim më shumë në mediat profesioniste apo tek gazetaria qytetare? Nëse duhet që të gjitha format e medias profesioniste të përfshijnë gazetarinë qytetare etj?

Vëmendje e veçantë në këtë studim i është kushtuar intervistave me drejtorë dhe kryeredaktorë lajmesh, me moderatorët e emisioneve, me opinionistë dhe analistë, inxhinierë të teknologjisë dhe pronarë të medieve. Pse? Për të testuar nëse kanë marrë në konsideratë gazetarinë qytetare. Nëse thyejnë edicionet e lajmeve me foto, video, audio e mesazhe të marrë nga qytetarët gazetarë. Për të zbuluar se sa ka impaktuar audiencën në emisione në veçanti dhe në platformat profesioniste në tërësi. Çfarë buxhetesh janë planifikuar dhe çfarë investimesh po kryhen në teknologji. Se si e perceptojnë situatën aktuale në komunikimin masiv dhe si e parashikojnë të ardhmen e dy formave të gazetarisë etj.

Për të provuar pavarësinë si medium në duart e qytetarëve krahasuar me platformat profesioniste, janë sjellë shembuj konkretë me foto, video, shkrime dhe komente nga gazetaria qytetare në Shqipëri. Është vërtetuar roli që kanë pasur interneti, rrjetet sociale dhe telefonia mobile në organizimin e shoqërisë civile për të reaguar ndaj ngjarjeve, dukurive, fenomeneve, vendimeve qeveritare apo politike pa qenë nevoja e njoftimit dhe sensibilizimit nga mediat profesioniste.

Për të përcaktuar shkallën e penetrimit të internetit dhe teknologjisë dixhitale, pa të cilat nuk mund të ekzistojë gazetaria qytetare, ndihmesë të madhe në hulumtim kanë dhënë statistikën e marra nga Autoriteti i Kontrollit Elektronik dhe Postar (AKEP). Ky institucion jep të dhëna periodike vjetore për shtrirjen e telefonisë fikse dhe mobile, përhapjen e internetit në popullatë, pajisjen me karta sim dhe përdoruesit e kartave aktive 3 dhe 4 G broadband, të dhëna këto që ndihmojnë për të treguar se si po rritet gazetaria qytetare në Shqipëri e cila siç e nënvizova është e lidhur pazgjidhshmërisht me internetin, rrjetet sociale dhe medien e lëvizshme.

Përkufizimi dhe koncepte të përgjithësime mbi gazetarinë qytetare

Gazetaria qytetare është grumbullimi, shkrimi, fotografimi, filmimi, redaktimi, prodhimi dhe shpërndarja e lajmeve nga njerëz jo të trajnuar si gazetarë profesionistë.

Ky proces realizohet me anë të internetit dhe pajisjeve dixhitale si; smartfonë, tableta, laptopë, telefonë, kamera, aparate fotografikë dhe të gjitha llojet e teknologjisë së lëvizshme që mundësojnë komunikim dhe transmetim të informacionit.

Courtney C. Radsc, profesore në fushën e gazetarisë dhe komunikimit në Amerikë e përcakton gazetarinë qytetare “si një alternativë dhe formën e aktivistit në mbledhjen e lajmeve dhe raportimit që funksionon jashtë institucioneve të medias së zakonshme, shpesh si një shprehje për mangësi në fushën profesionale gazetareske, që përdor praktika të ngjashme, por është e shtyrë nga objektivat dhe ideale të ndryshme dhe mbështetet në burime alternative të legjitimitetit të gazetarisë tradicionale”.³ Jay

Rosen propozon një përkufizim më të thjeshtë: “Njerëzit e njohur më parë si audiencë që shfrytëzojnë pajisjet e tyre për të informuar njëri-tjetrin, kjo është gazetari qytetare”.⁴

Gazetaria qytetare është e njohur edhe si: gazetaria publike, gazetaria me pjesëmarrje, gazetaria bazë, gazetaria hiperlokale, gazetaria demokratike, gazetaria në rrjet, gazetaria poshtë e lart, vetë gazetaria, gazetaria e shpërndarë, gazetaria pa filtër, gazetaria guerile, gazetaria e rrugës, etj.

Për shkak të disponueshmërisë së teknologjisë, qytetarët shpesh mund të raportojnë lajme “break” më shpejt se gazetarët tradicionale të medias. Shembuj të dukshëm të gazetarisë qytetare është raportimi nga ngjarje të mëdha botërore siç janë, Kullat Binjake, Pranvera Arabe, lufta në Siri, ISIS, tragjedia e Virginia Tech, pasojat e uraganit në Filipine, tërmeti në Haiti, shpërthimi i vullkanit në Etna, vrasjet terroriste në revistën humoristike Charlie Hebdo etj.

Në Shqipëri

Kulmin gazetaria qytetare shqiptare e arriti në protestat kundër asgjësimit të helmeve kimike siriane. Nuk ishin as media, as televizionet, as gazetat dhe as politika që sinjalizuan rrezikun që u kanosej të gjithëve. Por interneti, rrjetet sociale dhe sitet qytetare u bënë shkak për ndezjen e flakës së kundërshtimit anekënd vendit.

Radsc, Courtney C. (ACJ PressCard2014: <http://www.acj-eu.org/citizen-journalism-what-is-it/>).

⁴ Rosen, Jay. The Future of Journalism, October 14, 2008.

Në janar të vitit 2014 nisën protestat për të mos lejuar devijimin e rrjedhës së lumenjve Radika dhe Vjosa, pas projekteve të vendeve fqinjë në favor të interesave të tyre kombëtare.

Shoqëria civile ndërmerr nismën për “Shqipëria jo duhanit” duke organizuar aktivitete sensibilizuese në disa qytete të Shqipërisë. Rol të dorës së parë po luajnë blogjet, gazetaria qytetare dhe rrjetet sociale.

Qytetarët gazetarë po luajnë rol të madh në thyerjen e edicioneve të lajmeve për platformat profesioniste. Të gjithë mediet në versionin online dhe në smartfonë kanë krijuar opsione që mundësojnë raportime direkte nga qytetarët duke i bërë ata të parët në lajmin e fundit në procesin e informimit.

Janë të panumërt shembujt kur qytetarët gazetarë kanë dërguar të parët lajmin me mesazh, foto, audio dhe video drejt platformave profesioniste p.sh në alarmet sos me gomonet në det, në aksidente, në fatkeqësi natyrore si përmbytje, shembje, bllokime, zjarre etj.

Gazetaria qytetare në Shqipëri po mban edhe statusin e gazetarisë investigative. Madje në mjaft raste ajo e ka përbushur këtë mision më mirë se gazetaria profesioniste. Ka plot shembuj të denoncimit të rasteve për korrupsion, abuzimeve me detyrën, ndotjen, shpërdorimet e fondeve publike etj.

Disa nga fazat e ngritjes

a- Interneti

Interneti ka shkaktuar ndryshime të rëndësishme në gazetari. Mbetet për t’u parë saktësisht se si këto ndryshime do të shfaqen dhe evoluojnë. Interneti ka ndryshuar tashmë dinamikën e lajmeve dhe nga konsumator u ktheje në kontribues.

John Pavlik nuk e teproi kur ai përshëndeti internetin si «të parin dhe ndoshta mediumin më të fuqishëm interaktiv të komunikimit global». ⁵

Ai jo vetëm që është një medium global. Ai gjithashtu është gjithashtu në gjendje të integrojë të gjitha format e tjera të komunikimit. Ndërsa televizioni arriti të kombinojë vetëm audion dhe videon, interneti integron “të gjitha aftësitë e mediave të vjetra si (tekst, imazhe, grafikë, animacion, audio, video, shpërndarjen në kohë reale)». ⁶ Akoma më tepër, interneti mundëson “interaktivitet, kontrollin e përdoruesit dhe porosi”. ⁷

Interneti është bërë padyshim një formë e masmedias. Por kjo nuk është e gjitha. Interneti është ende në rritje e zhvillim. Si përdorues ne do të zbulojmë forma të reja dhe fuqinë komunikuese të tij.

b- Blogimi

Shpesh gazetaria qytetare identifikohet me blogimin. Blogosfera është një gazetë online, një hapësirë personale në internet që një blogger (dikush) mund të shkruajë aty çfarë dëshiron. Blogjet mund të krahasohen me yjet që përhapen në qiell. Shifra e tyre tashmë është vërtet impresionuese. Në prill 2007 matësi Technocrati raportoi se “ Blogosfera është e fortë, dhe është maturuar si një pjesë me ndikim të rëndësishëm në web”. ⁸ Ndërsa një numër i mirë i këtyre blogjeve janë personalë dhe me numër të vogël lexuesish, ka një numër të tjerë që janë rritur në rang kombëtarë e ndërkombëtarë.

Fenomeni blogim ka ndryshuar peizazhin e informacionit. «Ata [blogjet] ishin mjeti i parë që e bënë atë të lehtë - ose të paktën më të lehtë - të publikuar në Web.» Kushdo me një kompjuter tani zotëron një gazetë të tijën. ¹⁰

Nuk janë më individë thjesht konsumatorët. Ata tani janë edhe prodhuesit e informacionit. Ky ndryshim i paradigmës nga konsumator në prodhues ka ndezur një lëvizje të tërë user-generated content e njohur si Web 2.0.

c- Web 2.0

Ky zhvillim është thjeshtë një tjetër mjet përmes të cilit prodhuesit mund të arrijnë konsumatorët në internet si një mjet për fuqizimin e tyre. U quajt “Web 2.0”. “Në moshën e Web 2.0, ju tani jo thjesht mund të gjeni një film. Ju mund të krijoni filmin tuaj. Ta shpërndani atë në të gjithë botën. Ju mund të merrni feedback se çfarë mendojnë njerëzit në çast”.¹¹

Disa nga faqet e internetit të vleshme që promovojnë Web 2,0 përfshijnë:

Amazon.com, Wikipedia, YouTube, Digg, Last.fm. Lista pasurohet çdo ditë për të ardhur tek gjeneratat e famshme të

Facebook, Twitter, Flickr, Instagram etj.

d- Ekran i tretë

Telefonia mobile e mishëruar në smartfonë dhe pajisje të jera intelgjente, e njohur ndryshe edhe si “ekrani i tretë”, është duke zëvendësuar gjithnjë e më shumë kompjuterin. Madje vitet e fundit mund të thuhet se kjo lloj teknologjie, e kombinuar me wireless dhe shërbimet 3-4-5G, kanë mundur “ekranin e dytë”. Sepse softuerët e smartfonëve ofrojnë gjithçka që përmban interneti, që nga motorët e kërkimit, rrjetet sociale, faqet ueb, deri tek transmetimet live të kanaleve televizivë. Apps-et e tyre mundësojnë çdo gjë në kohë reale në çdo kënd të globit.

Pavlik, John V. *Journalism and New Media* (New York: Columbia University Press, 2001),xii.

Ibid., 4.

Ibid.

Ibid.

Gillmor, Dan. *We The Media*, 28.

¹⁰ Kolodzy, Janet. *Convergence Journalism: Writing and Reporting across the News Media* (Maryland: Rowman & Littlefield

Publishers, Inc.,

2006), 219.

Howe, Jeff. “Your Web, Your Way,” *TIME*, December 2006-January 2007, 60.

Lloje të gazetarisë qytetare

Lajme hiperlokale- Backfence.com e cila u lejon njerëzve të bëjnë gjithçka që ata do të bënin pikërisht nëse do të bisedonin mbi një gardh.

Lajme ndërkombëtare - Globalvoicesonline.org ka për qëllim të «plotësojë bisedat globale duke tërhequr vëmendjen e zonave dhe njerëzve që neglizhohen në mediat kryesore».¹²

Gazeta Online - Ohmynews.com inkurajon sloganin “çdo qytetar të jetë një reporter”.¹³ Kjo faqe ka mbi 250 mijë bashkëpunëtorë në gjithë botën.

Lajme bashkëpunuese - Wikinews.org. Nisur nga i njëjti softuer teknologjik si wikipedia, wikinews përdor një wiki për të mundësuar këdo të rishikojë ose të kontribuojë në përmbajtje.¹⁴

Pesë Top Ten Sitet e gazetarisë qytetare në internet

Third Report me 18% të totalit të gazetarisë qytetare në internet.

Në vendin e dytë është iReport i rrjetit të fuqishëm botëror CNN me 15% të totalit të kësaj gazetarie.

Në vendin e tretë me 13 % të përdoruesve renditet Global Voices Online.

Vendi i katërt me 11 % rendit Local By Us.

Në pozicionin e pestë me 10 % ndodhet NoozDesk.¹⁵

Faqe ueb e gazetarisë qytetare në CNN, iReport ka një strukturë të tillë ndërtimi: Në krye qëndrojnë ikonat “Main” (kryesoret), “Explore”(eksploro), “Assignments” (detyrë), “Profile” (profili) dhe “Upload” (ngarkim).¹⁶


Panorama e penetrimit të internetit, telefonisë fikse dhe të lëvizshme në Shqipëri deri në qershor

2014 (Bazuar në të dhënat e AKEP (Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare)¹⁷

Në fund të qershorit 2014 në Shqipëri numri i pajtimtarëve të telefonisë celulare të matur sipas kartave SIM aktive shkoi rreth 4.9 milion dhe numri i pajtimtarëve të matur sipas përdoruesve celularë aktivë (pajtimtarë që kanë përdorur shërbime celulare në 3 muajt e fundit) 3.5 milion.

Numri i pajtimtarëve me akses broadband fiks dhe celular (3G me karta USB/modem) në fund të qershorit arriti në rreth 324 mijë.

Figura 5 tregon numrin e pajtimtarëve me akses broadband të rrjeteve fiks dhe 3G deri më 30 qershor 2014 (Sipas AKEP)



Global Voices Team, Global Voices Online >> About, <http://www.globalvoicesonline.org/about/>.

Hauben, Jay. “Happy Seventh Birthday OhmyNews,” OhmyNews International, February 2, 2007, http://english.ohmynews.com/articleview/article_vieë.asp?article_class=8&no=346611&rel_no=1.

Kolodzy, Convergence Journalism, 235.

<http://www.thetoptens.com/citizen-journalism-sites/>

<http://ireport.cnn.com/>

<http://www.akep.al/>

Shkalla e penetrimit të internetit në popullsinë shqiptare nga rrjetet fikse dhe mobile është 11.46% për 100 banorë. Ndërsa për numër familjesh ai shkon në 45%.

Analiza

Çfarë rezultoi nga 2 profile ndërveprimi të mediave të njohura ndërkombëtare me gazetarinë qytetare. (Bazuar në një studim të Institutit Reuters)

Rezultatet e gjetura nga anketimet

Emisionet “Opinion”, “Top Story”, “Koha për tu Zgjuar” dhe “Aldo Morning Show” u monitoruan për një periudhë 2 vjeçare. Nga ky monitorim rezultoi se:


Emisioni i mëngjesit “Koha për tu zgjuar” me moderator Bashkim Hoxha ka një strukturë të tillë funksionimi ku qytetarët ftohen të flasnin direkt në linjë telefonike jo më shumë se 2 minuta për të trajtuar shqetësime dhe problematika nga komuniteti.¹⁸ Nga monitorimi 2 vjeçar që i bëra këtij emisioni (2013-2014) konstatova se mesatarisht në ajër dalin 15-20 telefonata nga një përzgjedhje rastësore që kryen aparatura e linjës telefonike. Moderatorin u kërkon qytetarëve të trajtojnë problematika që kanë të bëjnë me shqetësimet e komunitetit, por telefonuesit janë të prirur të diskutojnë për konfliktet që ekzistojnë mes lidërve të dy forcave kryesore politike. Njëkohësisht ata tërhiqen edhe nga mjaft tema me karakter kombëtar si skandalet, korrupsioni etj.

Nga anketimet e kryera me telefonata direkte me qytetarë, por edhe sipas të dhënave të matësit të specializuar Telemetrix, rezulton se emisioni “Koha për tu zgjuar” kap audiencën më të madhe në orët e mëngjesit. Dhe sipas vetë qytetarëve ai është më i preferuari pikërisht për faktin se ofron mundësinë e bashkëpunimit me qytetarët.¹⁹

Nga të dhënat e “Telemetrix”, rezulton se nga ora 6:00 deri në 8:00 të mëngjesit, “News 24”, mbetet kanali më i ndjekur, duke lënë pas edhe televizionet kryesore si “Klan” apo “Top Channel”.

“Wake Up”²⁰ renditet i dyti pas “News 24” deri në orën 8:00, kur e ndjekin kryesisht ata që preferojnë të informohen, teksa bëhen gati për të shkuar në punë. “Aldo Morning Show”²¹ i “TV Klan” kalon i pari vetëm pas orës 8:00, kur me programin e tij argëtues arrin të marrë të gjithë vëmendjen e shtëpiakeve.²²

Figura 6 tregon kurbën e ecurisë së emisioneve të mëngjesit sipas Telemetrix



Monitorimi i emisioneve Opinion dhe Top-Story

Vëmendja kryesore e këtij studimi u përqëndrua në emisionet Opinion²³ dhe Top Story.²⁴ Këta janë dy emisionet që bashkëveprojnë në shkallë të lartë me rrjetet sociale dhe gazetarinë qytetare. Gjithashtu këto janë edhe dy top emisionet më të ndjekura nga shqiptarët.

<http://www.balkanweb.com/site/emisioni-koha-per-tu-zgjuar/>
<http://www.monitor.al/gara-per-audencen-e-mengjesit-zgjimi-me-bashkim-hoxhen/>
<http://top-channel.tv/new/tv/program.php?idp=19>
<http://tvklan.al/category/program-tv/aldo-morning-show/>
<http://www.telemetrix.al/>
<https://www.facebook.com/pages/OPINION-TV-KLAN/41211432197?fref=ts>
<http://top-channel.tv/new/tv/program.php?idp=4>

Për të provuar se cili është impakti i gazetarisë qytetare në suksesin e tyre u krye një monitorim 2 vjeçar nga muaji prill 2013 deri në prill 2015. Nga ky monitorim rezultoi se emisioni “Opinion” me moderator Blendi Fevziu është më i ndjekur. Por ka raste kur ndërron vendin me emisionin “Top Story” me moderator Sokol Ballën. Kjo varet nga të ftuarit në emision dhe nga problematika që trajtohet.

Për të zbuluar se çfarë impakti ka gazetaria qytetare u studiua në vijimësi për 2 vjet mënyra se si operon moderatori për ta ndërthurrur emisionin me qytetarët dhe rrjetet sociale. U kryen anketime direkte me telefonata me qytetarë, u përzgjedhën rastësisht 100 ndjekësit dhe komentuesit më aktivë të emisioneve “Opinion” dhe “Top Story”. Ju referova intervistave direkte me moderatorët, si dhe faktit se sa aktivë janë vetë ata në rrjetet sociale.

Moderatori Blendi Fevziu dhe stafi i tij e shpallin temën disa orë përpara emisionit në faqen e emisionit në rrjetet sociale Facebook, Twitter dhe Instagram. Aty u kërkohet qytetarëve që të japin mendime ose të drejtojnë pyetje për temën e emisionit.

Sapo prezanton temën e emisionit moderatori Blendi Fevziu lidhet me faqen e emisionit në facebook dhe fton qytetarët të drejtojnë pyetje apo bëjnë komente. Gjatë emisionit ai i fton herë pas here qytetarët dhe në harkun kohor të dy orëve e bën këtë veprim 10-15 herë.

Në fund stafi përzgjedh disa nga mijëra komentet që vijnë drejt emisionit dhe ose u drejtohet të ftuarve, ose lexon opinionet që ata japin.

Emisioni “Opinion” ka 203.500 ndjekës në facebook. Moderatorin ndërvepron me emisionin e tij edhe në titter ku ai personalisht ka 43. 4 K ndjekës.²⁵ Mjaft me sukses po ndiqet emisioni edhe në Instagram.

Moderatori Sokol Balla gjithashtu operon me tre rrjetet sociale më të ndjekura ndër qytetarë facebook, twitter dhe instagram. Edhe z. Balla e publikon temën disa orë para emisionit në rrjetet sociale ku fton qytetarët të bëjnë pyetje ose të japin mendime.

Nga monitorimi i emisionit rezultoi se ai u drejtohet qytetarëve mesatarisht 5-10 herë gjatë emisionit, pra në një frekuencë më të ulët se moderatori Fevziu. Emisioni “Top Story” ka 3900 ndjekës në facebook. Por vetë moderatori duket se gëzon popullaritet më të madh në twitter me 54. 2 K ndjekës të cilët japin mendime ose drejtojnë pyetje nga twitter-i. ²⁶ Në twitter moderatori Sokol Balla publikon herë pas here deklaratimet e të ftuarve.

Nga anketimet direkte me qytetarë rezultoi se preferonin më shumë të ndiqnin një emision që bashkëvepron me rrjetet sociale dhe me vetë ata. Se një bashkëpunim i tillë e bënte më të besueshëm, më transparent dhe më të dobishëm emisionin. Nga 200 telefonata të rastësishme me qytetarë rezultoi se 40 prej tyre kishin qenë aktivë në murin e emisionit duke dhënë opinione apo duke drejtuar pyetje për emisionet. Por shumë prej të telefonuarve u shprehën se nuk kishin mundësi ose akses në internet që të mund të bënin komente apo të drejtonin pyetje moderatorit.

90 nga 100 e të anketuarve si më aktivët në muret e emisioneve pohuan se bashkëpunimi është i domosdoshëm dhe se do të reagonin në murin e emisionit sa herë që do tu jepej mundësia. Të anketuarit deklaruan se do të preferonin që të lidheshin edhe direkt me telefon me moderatorin ose të ftuarit.

Nga një anketim që zhvilloi gazeta Info Elbasani në qarkun e Elbasanit rezultoi se në një kampion prej 500 lexuesish 150 prej tyre u shprehën se kishin nisur mesazhe, foto apo video drejt gazetave, televizioneve apo edhe gazetarëve për ti njoftuar për ngjarje të ndryshme. Ndërsa 320 kishin hedhur në internet mesazhe, foto, video apo komente nga ngjarje të zakonshme ose familjare. (Këtu duhet mbajtur parasysh fakti se lexues janë edhe moshë të thyera dhe ata që nuk kanë akses në internet).

345 prej tyre parapëlqenin mediat që bashkëvepronin me qytetarët apo rrjetet sociale. 87 u përgjigjën se mediat profesioniste nuk duhet ti besojnë shumë gazetarisë qytetare. Ndërsa 68 pohuan se nuk u intereson se çfarë bëjnë mediat.

Intervistat

Për të plotësuar kuadrin e zbulimit të impaktit të gazetarisë qytetare në platformat profesioniste realizova një sërë intervistash me profesorë, drejtorë të informacionit, kryeredaktorë, moderatorë emisionesh, analistë dhe inxhinierë të teknologjisë.

Mes të intervistuar veçoj Dan Gillmor, profesor në Arizona State University’s Walter Cronkite School of Journalism and Mass Communication si dhe bashkëpunëtor në Berkman Center for Internet & Society at Harvard University.

U intervistuan moderatorët Blendi Fevziu, Sokol Balla, drejtori i informacionit në ABC News Armand Shkullaku, gazetari, ish kryeredaktor dhe moderator Enkel Demi, kryeredaktori i lajmeve në Top-Channel Mentor Kikia, analisti Lutfi Dervishi.

Moderatorëve ju drejtua një grup pyetjesh që kishin të bënin me ndërveprimin e emisionit me gazetarinë qytetare dhe rrjetet sociale. Drejtorëve dhe kryeredaktorëve një grup pyetjesh që kishin të bënin me rolin e gazetarisë qytetare në thyerjen e edicioneve të lajmeve dhe opinionistëve apo analistëve pyetje që kishin të bënin me perceptimet që ata kishin për gazetarinë qytetare.

Prof Gillmor shprehet se “publiku mund të jetë pjesë e vlefshme e procesit të raportimit. Mediat tradicionale mund të ftojnë audiencat e tyre për të marrë pjesë në raportim”. Por sipas tij edhe pse është i nevojshëm ky kohezion, gazetaria qytetare nuk pritet që ta zëvendësojë gazetarinë profesioniste. Ai theksoi rolin që ka teknologjia për zhvillimin e mediumit të ri. ²⁷

Moderatorët Blendi Fevziu dhe Sokol Balla u shprehën se rrjetet sociale dhe gazetaria qytetare tashmë janë pjesë integrale e emisioneve të tyre. Se kanë impakt të pa diskutueshëm në këto emisione dhe se në të ardhmen do e rrisin këtë bashkëpunim duke siguruar forma e metoda të reja, duke rritur stafet, duke implementuar risitë teknologjike etj.

<https://twitter.com/BlendiFevziu>

<https://twitter.com/sokolballa>

Gillmor, Dan. intervistë me autorin: <https://mail.google.com/mail/u/0/?tab=Xm&pli=1#search/Dan+Gillmor/14b980e25b92fa3e>

Të gjitha kategoritë e të intervistuarve pohuan se gazetaria qytetare ka të bëjë me nevojën për shprehje të lirë, pjesëmarrje, denoncim dhe intrigë.²⁸ Se gazetaria qytetare në Shqipëri është komplementare dhe shpesh më e shpejtë dhe e zëshme se gazetaria tradicionale.²⁹ Është një mënyrë, masive pa kosto ndaj shumë shpejt mori trajtën e një “epidemie”. Është një zhvillim shumë i mirë, një revolucion në fushën e komunikimit që ka ndikim në audiencë. Njerëzit kanë mundësi alternative informimi që janë më argëtuese, më praktike dhe më të shpejta.³⁰

Të intervistuarit pohuan se ndërthurja e formave tradicionale me gazetarinë qytetare shoqërohet me më shumë akses në publik dhe audiencë dhe se ky është edhe konkluzioni ku kanë dalë vetë kompanitë. Ndaj të gjitha kompanitë mediatike po mendojnë për përsosjen e teknologjisë dhe instalimin e softuerëve.

Të gjithë të intervistuarit pohuan se gazetaria qytetare ka pa diskutim impakt në platformat tradicionale. Sipas tyre bashkëpunimi rrit shumëllojshmërinë dhe pra pasuron menunë. Se gazetaria qytetare shpesh ka impakt plotësues, por edhe dominant e vendimtar.³¹ Është dhe do të jetë gjithnjë e më shumë sfiduese, por edhe komplementare.³²

Por sipas tyre kjo formë e komunikimit ka disavantazhet e veta që kanë të bëjnë me objektivitetin, besueshmërinë, mungesën e profesionalizmit, background-in e raportuesit, gjuhën e urrejtjes apo axhenda të fshehura personale. Duke qenë jashtë kontrollit ka rrezik të madh abuzimi dhe shpërdorimi. Media online dhe për pasojë edhe gazetaria qytetare është ende kaotike. Të intervistuarit gjithashtu sugjerojnë një ligj për rregullimin e marrëdhënieve virtuale, përcaktimin e etikës së komunikimit dhe dënimin e agresivitetit, shantazhit dhe kërcënimit.³³

Sa i përket së ardhmes ata mendojnë se dy format e gazetarisë do të jenë në simbiozë. Nuk do të jenë në konflikt por në marrëdhënie komplementare. E ardhmja është integrimi i platformave. Më shumë informacioni, më shumë ndërveprim dhe më shumë varësi....³⁴

Nga studimi i të dhënave të marra nga AKEP rezulton se rritja e penetrimit të internetit, teknologjisë dixhitale, broadbandit dhe medias së lëvizshme është shoqëruar me rritjen e aktivitetit të gazetarisë qytetare.

Konkluzione dhe rekomandime

Audienca janë bërë pjesë e komunikimit masiv.

Ky medium është më i pavarur se platformat profesioniste.

Mediat tradicionale po ftojnë audiencat duke i bërë pjesë të procesit. Qytetarët nuk janë më thjeshtë konsumatorë të informacionit por edhe prodhues të tij.

Nga studimi rezulton se gazetaria qytetare po ndihmon në plotësimin e informacionit për platformat profesioniste. Për ngjarje të veçanta të jashtëzakonshme edhe ndikim dominues.

Rekomandohet që platformat tradicionale të implementojnë risitë teknologjike, të rrisin stafet dhe krijojnë infrastrukturën e nevojshme për bashkëpunim me rrjetet sociale dhe median qytetare.

Zhvillimi i gazetarisë me pjesëmarrje varet nga interneti, teknologjia dixhitale dhe WiFi, si dhe teknologjia e lëvizshme (mobile). Shteti duhet të hartojë strategji dhe krijojë lehtësira për përhapjen e tyre në mënyrë që gjithë qytetarët të kenë akses dhe mundësi të informohen dhe informojnë.

Për të shmangur abuzimet me objektivitetin dhe besueshmërinë nevojiten filtra kontrolli.

Shoqëria, industria e medias dhe qeveria duhet të përipiqen të hartojnë kuadrin ligjor për të standardizuar përdorimin e internetit, rrjeteve sociale dhe medias online.

Profesorë, studiues të fushës, drejtues mediesh profesioniste, qytetarë gazetarë aktorë të ndryshëm, parashikojnë bashkëzistencën harmonike mes dy formave të gazetarisë që do të mundësojnë rritjen e informimit të shoqërisë.

Bibliografia

Dominick, J. Dinamika e Komunikimit Masiv, UET Press 2010 f. 60, 63

Demi, E. intervistë me autorin: <https://mail.google.com/mail/u/0/?tab=Xm&pli=1#search/Enkel+Demi/14c332d2b456a1be>

Dervishi, L. Intervistë me autorin: <https://mail.google.com/mail/u/0/?tab=Xm&pli=1#search/Lutfi+Dervishi/14b02773b35a91e4>

Gillmor, D. intervistë me autorin: <https://mail.google.com/mail/u/0/?tab=Xm&pli=1#search/Dan+Gillmor/14b980e25b92fa3e>

Gillmor, D. We The Media, f. 28.

Global Voices Team, Global Voices Online >> About, <http://www.globalvoicesonline.org/about/>.

Hauben, J. “Happy Seventh Birthday OhmyNews,” OhmyNews International, February 2, 2007, http://english.ohmynews.com/articleview/article_view.asp?article_class=8&no=346611 &rel_no=1.

Howe, Jeff. “Your Web, Your Way,” TIME, December 2006-January 2007, 60.

Demi, Enkel. intervistë me autorin: <https://mail.google.com/mail/u/0/?tab=Xm&pli=1#search/Enkel+Demi/14c332d2b456a1be>

Dervishi, Lutfi. intervistë me autorin: <https://mail.google.com/mail/u/0/?tab=Xm&pli=1#search/Lutfi+Dervishi/14b02773b35a91e4>

Kikia, Mentor. intervistë me autorin: <https://mail.google.com/mail/u/0/?tab=Xm&pli=1#search/Mentor+Kikia/14b30401baf92bc4>

Demi, Enkel. intervistë me autorin

Dervishi, Lutfi. intervistë me autorin

Demi, Enkel. intervista me autorin

Dervishi, Lutfi. intervista me autorin

<http://ireport.cnn.com/>
<http://top-channel.tv/new/tv/program.php?idp=19>
<http://top-channel.tv/new/tv/program.php?idp=4>
<http://tvklan.al/category/programe-tv/aldo-morning-show/>
<https://twitter.com/BlendiFevziu>
<https://twitter.com/sokolballa>
<http://www.akep.al/>
<http://www.alexa.com/topsites/countries/AL>
<http://www.balkanweb.com/site/emisioni-koha-per-tu-zgjuar/>
<https://www.facebook.com/pages/OPINION-TV-KLAN/41211432197?fref=ts>
<http://www.internetworldstats.com/stats4.htm>
<http://www.monitor.al/gara-per-audencen-e-mengjesit-zgjimi-me-bashkim-hoxhen/>
<http://www.telematrix.al/>
<http://www.thetoptens.com/citizen-journalism-sites/>
 Kikia, M. intervistë me autorin: <https://mail.google.com/mail/u/0/?tab=Xm&pli=1#search/Mentor+Kikia/14b30401baf92bc4>
 Kolodzy, J, *Convergence Journalism*, 235.
 Kolodzy, J, *Convergence Journalism: Writing and Reporting across the News Media* (Maryland: Rowman & Littlefield Publishers, Inc., 2006), 219.
 Newman, N, *The rise of social media and its impact on mainstream journalism*. September 2009. fq 7-11
 Newman, N, *The rise of social media and its impact on mainstream journalism*. September 2009. pp 18-21
 Pavlik, J. *Journalism and New Media* (New York: Columbia University Press, 2001), xii.
 Ibid.
 Radsc, C. (ACJ PressCard2014: <http://www.acj-eu.org/citizen-journalism-what-is-it/>).
 Rosen, J. *The Future of Journalism*, October 14, 2008.

INTEGRIMI I INSTITUCIONEVE PARALELE GJYQËSORE TË VERIUT TË KOSOVËS, REALITET KUSHTETUES APO INTEGRIM MBIKUSHTETUES

RAFET HAXHAJ

Doktorant UET, E Drejtë Publike

Email: dugi-15@hotmail.com

ABSTRAKT

Kosova në bazë të Rezolutës së OKB 1244 në vitin 1999 u vendos nën administriminn ndërkombëtar. Kjo Rezolutë përcaktonte që i tërë aparati ekzistues i vendosur nga pushteti serb në Kosovë do të pushonte së ekzistuari, dhe në këtë kohë do të ndërtoheshin institucione të reja nën administrimin e Misionit të UNMIK. Ndonëse në pjesën më të madhe të Kosovës kjo gjë u respektua, kjo nuk ka ndodhur edhe me institucionet gjyqësore në pjesën veriore të Kosovës. Kosova edhe pse ishte vënë nën administrimin ndërkombëtar, Serbia në këtë pjesë të Kosovës formoi institucionet gjyqësore të cilat u përgjigjeshin dhe u jepnin llogari institucioneve gjyqësore të Serbisë. Edhe shkallshmëria gjyqësore sipas të drejtës së ankimit realizohej në Serbi. Një realitet interesant kur gjykatat e krijuara nga UNMIK nuk arritën që të marrin primatin e pushtetit gjyqësor në këtë pjesë të Kosovës. Çështje e vërteta, objektet e këtyre gjykatave u pushtuan nga banorët serb të pjesës veriore, kur Kosova shpalli pavarësinë e saj në shkurt të vitit 2008. Gjykatësit shqiptar që punonin këtu, u transferuan që të punojnë në një qytet tjetër të Kosovës. Çështja e integritit të institucioneve gjyqësore paralele u shtrua dhe u arrit me Marrëveshjen e Brukselit të 19 Prillit 2013, në bisedimet në mes të Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e BE. Punimi synon të analizoj çështjen se, integrimi sipas kësaj marrëveshje a ka tejkaluar kornizat që kishte vënë Plani i Ahtisarit dhe vet Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Punimi gjithashtu synon të analizoj atë se ky lloj integrimi a përbën një realitet të mirëfilltë kushtetues, apo ngërthen në vete integrimin mbikushtetues që tejkalon parimet bazë të vëna nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Fjalë kyç: Rezolutë, administrim ndërkombëtar, institucione gjyqësore, integrim

Hyrje

Pas përfundimit të luftës në Kosovë gjendja në sistemin gjyqësor rezultoi të jetë tejte kaotike. Së bashku me forcat ushtarake e policore, u larguan edhe bartësit e pushtetit të Serbisë, pushtet ky i instaluar që me suprimimin me dhunë të autonomisë së Kosovës qysh në vitin 1989. Gjyqtarët dhe prokurorët kosovar që ishin larguar nga puna, nga ana e këtij pushteti okupues, për dhjetë vite kshin mbetur jashtë sistemit gjyqësor. Në një gjendje të tillë, menjëherë pas përfundimit të luftës, u imponua nevoja që të formoheshin format e para të funksionimit të sistemit gjyqësor. Në njëzetditëshin e parë pas hyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) përmes një rregullore themelon Këshillin e Përbashkët Këshilldhënës mbi Emërimet e Përkohëshme Gjyqësore. Ky organizëm i parë në sferën e gjyqësisë, kishte për mandat të bënte propozimet e para për emërimet gjyqtarëve. Kështu, filloi punën Sistemi Emergjent Gjyqësor dhe gjyqtarët vepronin në kuadër të Gjykatave të Përkohëshme të Qarkut dhe kishin mandat tremujor. Në vendet e Kosovës që ende nuk kishin gjykata të formuara, vepronte Njësi Lëvizës që ishte nën juridiksionin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Në janar të vitit 2000, pas përgatitjes së kronizës ligjore fillon punën Sistemi i Rregullt Gjyqësor, kurse gjyqtarët dhe prokurorët në këtë kohë emërohen për një afat më të gjatë.

Përderisa në pjesën më të madhe të Kosovës filloi që të funksionoj sistemi gjyqësor i themeluar nga ana e UNMIK, një gjendje krejt tjetër mbretëroi në pjesën veriore të Kosovës. Problemet u shfaqën në qytetin e ndarë të Mitrovicës dhe dy komunave të tjera me popullatë shumicë të nacionalitetit serb, në Leposaviq dhe Zubin Potok. Në këto vende UNMIK instaloi gjykatat e themeluara nga ai vetë, por që numri i gjykatësve të nacionalitetit serb që pranuan që të punojnë nën administrimin e UNMIK ishte fare i vogël. Në anën tjetër për shkak se vendodhja e gjykatave ishte në pjesën veriore të qytetit të ndarë dhe që dominohej nga serbët, levizja e personelit dhe e palëve pjesmarrëse në proceset gjyqësore të nacionalitetit shqiptar, ishte tejte e kufizuar dhe bëhej vetëm nën përcjelljen e vazhdueshme të forcave të sigurisë.

Sistemi paralel gjyqësor i krijuar nga shteti i Serbisë në brendësi të territorit të Kosovës

UNMIK dhe Institucionet e Përkohëshme të Qeverisjes në Kosovë (IPVQ), nuk arritën që të shtrijnë funksionimin efikas në tërë territorin e Kosovës. Kjo u bë për shkakun se Serbia vazhdoi që të ndërtojë dhe përkrah institucionet e saj në brendësi të territorit të Kosovës, duke çënuar kështu rendin juridik dhe realitetin juridik që ishte krijuar pas vënies së Kosovës nën administrimin ndërkombëtar. Sikurse në pjesët tjera të pushtetit, paralelizma u shfaqën edhe në pushtetin gjyqësor. Serbia përbrenda territorit të Kosovës formoi gjykatat të cilat vepronin në enklavat serbe dhe posaçërisht ndikimin e madh të tyre e kishin në pjesën veriore të Kosovës. Këto gjykata vepronin pa autorizimin e UNMIK dhe drejtoheshin nga serbët etnik të Kosovës. Në këtë mënyrë në Kosovë u lejua që të veprojnë një sistem ku këto gjykata vepronin si gjykata të shkallës së parë kurse vendimet e tyre mund të apelohehin vetëm në gjykatat më të larta të Serbisë. Kështu, gjykatat e Serbisë kanë shqyrtuar rastet të cilat i përkisnin kompetencës territoriale të Kosovës. Këto gjykata punonin ekskluzivisht me ligjet e Serbisë dhe nuk njihnin ligjet dhe juridiksionin të cilit i përkiste Kosova.¹

Përveç këtyre strukturave gjyqësore të jashtëligjshme që veprnin brenda territorit të Kosovës, kanë ekzistuar edhe një varg institucioneve paralele të gjyqësorit që emërtoheshin si gjykata të Kosovës dhe që vepronin nëpër qytete të ndryshme të Serbisë. Këto gjykata vepronin në raste të ndryshme që kishin të bënin me serbët e Kosovës. Ka pasur raste që serbët e Kosovës kanë prezantuar vendime nga më të ndryshmet të nxjerra nëpër këto gjykata por që të cilat vendime nuk janë njohur dhe pranuar asnjëherë dhe nuk kanë patur efekt juridik para institucioneve legjitime të Kosovës.²

Realiteti jolegjitim i paralelizmave gjyqësor të Serbisë në Kosovë

Deri në nxjerrjen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Prill 2008), jeta institucionale në Kosovë rregullohej me Kornizën Kushtetuese të Kosovës (Rregullorja e UNMIK nr. 2001/9). Kjo kornizë ligjore kishte mbështetjen juridike në Rezolutën e KB 1244 e cila kishte autorizuar UNMIK si të vetmin autoritet legjitim me PSSP-në si autoritetin e fundit ligjor në Kosovë. Kjo kornizë ligjore, përjashtonte ekzistimin e dualizmave të akëcilil pushtet shtetëror brenda territorit të Kosovës, e aq më tepër pushtete të imponuara nga jashtë territorit të Kosovës.

Në kohën kur Kosova e përkrahur nga bashkësia ndërkombëtare po bënte përgatitjet e fundit për dhënien fund të një administrimi i cili udhëhiqej nga Kombet e Bashkuara, presidenti Marti Ahtisari harton Propozimin Gjithpërfshirës për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës. Propozimi kishte parashikuar që Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të ketë pavarësi të plotë në kryerjen e funksioneve të tij, me qëllim të sigurimit të një sistemi të integruar, të pavarur dhe profesional dhe të paanshëm të drejtësisë. Ku propozim gjithashtu kishte përcaktuar sigurimin e qasjes në drejtësi për të gjithë personat në Kosovë dhe garantimit që sistemi i drejtësisë së Kosovës është gjithpërfshirës dhe pasqyron plotësisht natyrën shumetnike

Haxhaj, R. (2008), *Sistemi Gjyqësor i Kosovës gjatë periudhës së Misionit të Kombeve të Bashkuara*- punim i magjistraturës- Fakulteti Juridik në Prishtinë, fq.72.

Gjykata të tilla kanë vepruar si Gjykata Komunale e Ferizajit e vendosur në Leskovc, Gjykata Komunale e Lipjanit e vendosur në Nish etj.

të Kosovës.³ Lidhur me pjesëmarrjen e pjestarëve të komuniteteve joshumicë në gjyqësor, Propozimi përcaktonte se së paku pesëmbëdhjetë përqind (15%) të Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, por në asnjë rast më pak se tre (3) gjyqtarë do të jenë nga komunitetet joshumicë në Kosovë. Në gjykatën e shkallës së dytë kjo përqindje është parashikuar që të jetë e njëjtë por me ndryshimin se në asnjë rast jo më pak se dy (2) gjyqtarë do të jenë nga komunitetet jo shumicë.

Plani i Ahtisarit në asnjë mënyrë nuk parasheh që komunat me shumicë etnike serbe në Kosovë siç janë Komuna e Mitrovicës Veriore, Graçanicës dhe Shtërpçës në kuadër të kompetencave të zgjeruara vetjake komunale të kenë në kompetencë edhe formimin e gjykatave.⁴ Në këtë çështje i është lënë në kompetencën e këshillit Gjyqësor të Kosovës që të miratojë apo jo kërkesat e tilla në rastet ku shumica e popullatës i takon komunitetit jo shumicë në Kosovë, dhe në të cilën nuk ka gjykatë themelore.

Integrimi mbikushtetues

Gjendja edhe më tepër u rëndua, në këtë pjesë të Kosovës (pjesën veriore), kur në shkurt të vitit 2008 Kosova shpalli pavarësinë e saj. Serbët lokal pushtuan me dhunë dhe mbajtën për javë të tëra të okupuara ndërtesat e gjykatave shtetërore të Kosovës, deri në ndërhyrjen e forcave të sigurisë. Që nga ajo kohë në këto ndërtesa punojnë me staf të pakët gjyqtar dhe prokuror ndërkombëtar nga misioni i EULEX. Edhe më tutje qasja e pjestarëve të nacionalitetit shumicë që janë shqiptarët, mbetet ende larg nga ndarja apo marrja e drejtësisë nga këto institucione.

Menjëhë pas shpalljes së pavarësisë Kosova miratoi Kushtetutën e saj e cila në mes tjerash garanton barazi para ligjit, të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore pa diskriminim, mos diskriminim në asnjë mënyrë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar apo ndonjë statusi tjetër personal. Kushtetuta ka përcaktuar se parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë.⁵ Sa i përket Sistemit gjyqësor Kushtetuta ka akceptuar në tërësi normativën e propozuar në Propozimin e Ahtisarit.⁶ Kosova vazhdoi me kryerjen e reformave në gjyqësi duke bërë nxjerrjen e ligjit të ri për gjykatat, dhe duke bërë përshtatjen e strukturës së gjykatave kushteve bashkëkohore dhe lënjen parapa, organizimeve të gjykatave të sistemit të kaluar.

Edhe pse Kushtetuta e Kosovës ofron garanci mjaft të avansuara për komunitetet jo shumicë dhe të drejtat e tyre, kjo nuk ka bërë që pjestarët e nacionalitetit serb të cilët jetojnë në pjesën veriore të mjaftohen me këto garanci kushteutese. Edhe përkundër zotimit të vazhduar politik të administratës ndërkombëtare dhe liderëve udhëheqës të Kosovës që çështja e strukturave paralele të zgjidhet, realiteti në terren vazhdoi të dëshmojë të kundërtën. Mungesa e sistemit gjyqësor plotësisht funksional në pjesën veriore të territorit të Kosovës, vazhdoi që të përbënte shkelje serioze të së drejtës për qasje në drejtësi, të drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, të drejtës për liri etj.

Marrëveshja e 19 prillit 2013 e arritur në Bruksel pas bisedimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë me ndërmjrtësimin e BE ka sjellë një realitet interesant në këtë pjesë të Kosovës. Ndonëse Kushtetuta e Republikës së Kosovës bazuar në Planin e presidentit Ahtisari ka përcaktuar kuotën prej 15 % nga cilado gjykatë e themeluar me juridiksionin e Apelit por jo më pak se dy (2) gjyqtarë do të jenë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë kjo gjë nuk është respektuar. Pas bisedimeve të cekura më lartë, në pjesën veriore të Mitrovicës po nga marrëveshja ka lindë një degë e gjykatës së Apelit me përbërje nga stafi administrativ dhe gjyqësor të cilët do të qëndrojnë përherë në pjesën veriore të Mitrovicës. Shumica e secilit panel gjykues në këtë gjykatë do të përbëhet nga gjykatës serbë të Kosovës. Thëksojmë se sistemi gjyqësor i Kosovës, para se të bëhet arritja e marrëveshjes kishte vetëm një Gjykatë të Apelit e cila ka juridiksion për tërë nivelin e Kosovës. Së këndejmi, pos themelimit të kësaj dege, marrëveshja ka shkuar edhe më tutje duke i dhënë kompetencën e vendosjes në shkallë të dytë kësaj gjykate edhe për çështjet gjyqësore që vijnë nga komunat tjera tjera më shumicë të popullsisë serbe në Kosovë, e të cilat bien në kompetencën territoriale të Gjykatës së Apelit me qëndër në Prishtinë. Pra në bazë të kësaj marrëveshje, për të njëjtën çështje që është kompetente të vendosë një gjykatë themelore në shkallë të parë e që është jashtë juridiksionit territorial të “gjyqësi së pjesës veriore”, do të vendosë në shkallë të dytë dega e Gjykatës së Apelit me seli në pjesën veriore të Mitrovicës.⁷

Nga bisedimet e fundit e të cilat edhe nuk kanë dalë së paku zyrtarisht deri më tani, nga sfera e gjyqësisë pjesa veriore do të ketë edhe Gjykatën Themelore me përbërje mbi 60% të stafit dhe gjykatësve të nacionalitetit serb. E njëjta përbërje do të jetë edhe për prokurinë sin e shkallë të parë, e poashtu edhe në shkallë të nivelit të apelit. Një realitet intersant me plot të papritura që pritet se do të ndodhin, do të paraqesin sfidë për të ardhmen e gjyqësorit dhe funksionimit të tij të mirëfilltë në tërë territorin e Kosovës. Sigurisht, se marrëveshjen e bën të vështirë që të funksionojë, fakti se sikur në pikat e saj në pjesën për gjyqësorin, më tepër i është kushtuar kujdes funksionimit të vijave etnike se sa atyre funksionale, dhe ofrimin të drejtësisë dhe respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut që kanë të bëjnë më të drejtën e qasjes në drejtësi, të drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme dhe së drejtës për liri. Vlerësojmë se Marrëveshja ka tejkaluar edhe kornizën e tanishme ligjore dhe atë kushtetuese dhe nuk ka bërë specifikimet e duhura se si do të veprohet në çështjet e përziera gjyqësore. Këtu mendohet posaçërisht për ato çështje që do të vendosen nga gjykatat e shkallës së parë jashtë juridiksionit të “kompetencës së dhuruar”, e në të cilat palët ndërgjyqëse do të jenë të nacionaliteve të përziera qoftë në anën paditëse qoftë në anën e palës së paditur.

Propozimi Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, 26 mars 2007 - neni 6.5.

Po, aty-neni 4.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës- neni 24.

Po, aty – nenet 102-108

Marrëveshja e arritur në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë –pika 10 dhe 11, - Gazeta expres dt.19.04.2013.

Konkluzion

Gjyqësori në Kosovë vazhdon që të përballet me vështirësi të shumëta. Përveç vështirësive të cilat e kanë kapluar në aspektin funksional përbrenda vet funksionimit dhe organizimit në pjesën më të madhe të territorit të Kosovës, gjyqësorit i janë shtuar edhe problematika të funksionimit të tij në pjesën veriore të Kosovës. Përmbushjet e kompetencave “të dhuruara” në këtë pjesë e bëjnë vështirë funksional dhe në funksion të përmbushjes së detyrave të tij parësore që janë ndarja dhe marrja e drejtësisë. Formulimet e bëra të njohura deri më tani nga marrveshja e arritur në Bruksel, shkojnë përtej asaj që ka paraparë Plani i Ahtisarit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Gjykatat. Gjyqësori i Kosovës pavarësisht problemeve të shumta me të cilat është përballur, asnjëhere gjatë punës së tij nuk ka shfaqur dallimet në vendosje të çështjeve duke favorizuar palën varësisht nga preardhja etnike. Kompetencat në gjyqësor që shfaqen të “shumë avansuara” në marrveshjen e Brukselit e bëjnë funksionimin e gjyqësorit në pjesën veriore, nga një realitet jo kushtetues në një integrim mbi kushtetues dhe vështirë për të funksionuar.

Bibliografia

- Haxhaj, R. (2008) *pozita e gjyqësorit në Kosovë gjatë periudhës së Misionit të Kombeve të Bashkuara*- punim i magjistraturës, Fakulteti Juridik në Prishtinë;
 Propozimi gjithpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës- 26 mars 2007;
 Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
 Ligji për Gjykatat i Kosovës;
 Gazeta Express dt.19.04.2013 (Marrëveshja e arritur në Bruksel në bisedimet në mes të Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e BE)

DEMOKRATIZIMI I KUSHTETUTËS SHQIPTARE KONFORM STANDARTEVE EUROPIANE

DR. CAND. IRISI TOPALLI

Akademia Profesionale e Biznesit, Fakulteti i Drejtësisë, Pedagogje / Përgjegjëse e Zyrës për Marrëdhëniet me

Jashtë iris_topalli@hotmail.com

ABSTRAKT

Shteti shqiptar në njëzet e pesë vjet tranzicioni është dashur të përballet me sfida të ndryshme. Kur flitet për një shoqëri apo shtet në tranzicion, kryesisht përmenden vështirësitë dhe problematikat e hasura në jetën politike e social-ekonomike të vendit, por ajo çfarë në fakt është tipike si dhe e kuptueshme për këto shoqëri, është domosdoshmëria e inkompatibilitetit të parimeve dhe standardeve demokratike në legjislativën e tyre, duke filluar kështu që nga akti themelor që është kushtetuta. E në fakt, për shtetin shqiptar, kjo sfidë ka qenë dhe vazhdon të mbetet e dyfishtë, për sa kohë synimi për demokratizim përkon edhe me domosdoshmërinë e përafritit të legjislativës shqiptare me atë europian. Pikërisht në këtë pikë, mangësitë e legjislativës shqiptare janë të konsiderueshme, për t'u ndalur kështu në aktin themelor të shtetit, në aktin konform të cilit duhet të jenë gjithë aktet e tjera, në atë që francezët me të drejtë e quajnë si la tête de chapitre, pra kushtetutën shqiptare, e cila edhe pse në një vështrim apo lexim të përgjithshëm, "është përpjekur" për demokratizim, përsëri shfaq domosdoshmëri për plotësim në këtë aspekt. Mund të përmendim këtu mangësi të kushtetutës shqiptare, në kuadër të përputhjes së saj me standardet europiane, të cilat paraqiten në drejtim të diskriminimit dhe barazisë gjinore, neni 56 ku flitet në mënyrë shumë të limituar për të drejtën për t'u informuar për gjendjen e mjedisit, neni 59 ku parashikohen objektivat sociale të shtetit shqiptar apo edhe neni 42 ku parashikohet e drejta për një proces të rregullt ligjor. Pikërisht, të gjitha këto do të jenë fokus i këtij punimi. Metodologjia e përdorur është ajo e analizës dhe krahasimit.

Fjalë kyç: Kushtetutë, demokratizim, kritere, standarde europiane.

1. Hyrje

Përprjekjet për t'iu bashkuar familjes europiane për Shqipërinë kanë filluar që në vitin 1991 me themelimin e marrëdhënieve ndërmjet Komunitetit Ekonomik Europian (të asaj kohe) dhe Republikës Parlamentare të porsa krijuar. Që prej asaj kohe shumë përprjekje janë bërë nga ana e shtetit shqiptar, por pa dhënë rezultatet e pritshme që do të përmbushnin një nga ëndrrat më të vrullshme të tij, marrjen e statusit të vendit anëtar të Bashkimit Europian. Sigurisht që kjo mos përmbushje ka arsye të veta. Dhe një ndër më të rëndësishmet është edhe mos bërja mjaftueshëm rreth demokratizimit të legjislacionit shqiptar me standardet europiane, e kryesisht mos bërja mjaftueshëm rreth demokratizimit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e cila përbën *la tête de chapitre* në hierarkinë e ligjeve të shtetit shqiptar. Ajo përbën Aktin Themelor të shtetit shqiptar dhe për nga vetë rëndësia që paraqet, kërkon edhe vëmendjen maksimale mbi të gjitha ligjet e tjera për t'u trajtuar. Kjo është edhe arsyeja pse është zgjedhur kjo temë për tu studiuar, pasi është interesante, kurioze por edhe tejet e rëndësishme. Qëllimi është që të vërtetohet rëndësia e veçantë që ka demokratizimi i Kushtetutës shqiptare konform standardeve europiane.

Fokusimi i objektivave të këtij studimi do të përqendrohet në dy pjesë kyçe të organizuara në pyetje kërkimore dhe hipoteza. Së pari: Pse rezultoi kaq i gjatë procesi i tranzicionit në Shqipëri? Pse është kaq i mundimshëm përafrimi i procesit të demokratizimit shqiptar me ato të vendeve të tjera europiane? A është demokratizuar Kushtetuta shqiptare konform standardeve europiane? Të gjitha këtyre pyetjeve kërkimore ky studim do t'iu japë shpjegim në pjesë e dytë e të tretë të tij.

Një hipoteze e ngritur gjatë studimit është se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e ka përmbyllur tashmë procesin e demokratizimit të saj konform standardeve europiane, vërtetësia reale e të cilës do të mbetet për t'u provuar gjatë pjesës së tretë të studimit.

Nga mbledhja dhe analiza e materialeve të studiuara dhe të paraqitura në pjesët e lartpërmendura, do të bëhet e mundur të diskutohet dhe të kuptohet nëse iu është gjetur përgjigjja pyetjeve dhe hipotezave të parashtruara gjatë punimit.

Në përmbyllje të studimit gjenden konkluzionet dhe rekomandimet që paraqesin edhe rëndësinë apo dobishmërinë e këtij punimi.

2. Rruga e gjatë e tranzicionit në Shqipëri

Shteti shqiptar në njëzet e pesë vjet tranzicioni është dashur të përballlet me sfida të ndryshme. Kur flitet për një shoqëri apo shtet në tranzicion, kryesisht përmenden vështirësitë dhe problematikat e hasura në jetën politike e social-ekonomike të vendit. E vërteta është se në gjithë këtë periudhë të gjatë tranzicioni shqiptar ka ndikuar pashmangshmërisht edhe dimensionin historik. Shqipëria ka qenë, për 500 vjet, pjesë e Perandorisë Otomane, e cila karakterizohej nga një sistem perandorak sulltanistik dhe një sundim patrimonial dhe personalistik. Nga kjo, Shqipëria trashëgoi marrëdhënie të prapambetura shtet-shoqëri, kapacitet dhe struktura të dobëta institucionale si dhe një nivel të ulët të shoqërisë civile, duke u bërë një vend agrar e feudal me një masë të madhe fshatarësie. Më pas në Shqipëri u vendos një monarki autokratike, e cila zgjati deri në prag të shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore. Për këtë arsye, Shqipëria nuk trashëgoi një traditë të fortë të kapitalizmit dhe të demokracisë. Për më tepër, katër dekadat e sundimit komunist stalinist, shumica nën diktaturën e Enver Hoxhës, e thelluan më tej këtë prapambetje politike dhe social-ekonomike të vendit. Regjimi komunist zhdukoi pluralizmin politik dhe institucionet demokratike (liria e fjalës dhe e mendimit u shkatërruan brutalisht), zhvilloi një ekonomi të planifikuar, të centralizuar dhe kolektiviste, krijoi një komunitet kombëtar dhe ndërtoi një shoqëri socialiste “të bekuar me barazinë sociale dhe ekonomike”¹. Pra, ky është dimensionin historik i trashëguar nga Shqipëria, i cili detyrimisht theksoi ndasinë mes saj dhe pjesës tjetër të Europës. Por, në 1990, në Shqipëri regjimi komunist u përmbys duke i dhënë rrugë mendimit të përgjithshëm se tashmë i ishte hapur rruga procesit të demokratizimit dhe transformimeve. Dhe në fakt, duke ardhur nga një e shkuar shqetësuese komuniste dhe autoritare, duke qenë një prej vendeve më të izoluar në botë për më tepër se 45 vite, nën parimin absurd të ‘mbështetjes në forcat e veta’, ishte Bashkimi Europian që u pa si një lloj shpëtimtari për vendin dhe qytetarët e tij. Gjatë protestave të para antikomuniste në fillim të viteve 90² thirrja kryesore e brezit të ri ishte: “E duam Shqipërinë si gjithë Europa”. Pra, Bashkimi Europian në mendjen e shumë qytetarëve shqiptarë përfaqësonte një sërë vlerash dhe normash që kanë në themel parimin e demokracisë, lirisë dhe respektin për të drejtat e njeriut³. Por çfarë është në vetvete demokracia dhe procesi i demokratizimit? Sipas Pridham demokratizimi është i gjithë procesi i ndryshimit të regjimit nga sundimi totalitar deri në vendosjen e demokracisë liberale. Ai është një proces disa-fazësh dhe shumë-dimensional, i cili përfshin: përmbysjen e regjimit totalitar, liberalizimin e para-tranzicionit, tranzicionin demokratik, konsolidimin demokratik dhe së fundi demokracinë liberale. Gjithashtu Pridham argumenton se “demokracia nuk lind me ‘frymën e shenjtë’, por trashëgon një shumëllojshmëri të tipareve të së kaluarës të cilat mund ta ndërlikojnë procesin e ndryshimit të regjimit”. Ndërsa ka kaluar fazat e para të tranzicionit, Shqipëria po has vështirësi në arritjen e stadive finale të tij. Kjo si rezultat i disa faktorësh, së pari, Shqipëria pati një pikënisje shumë të dobët social-ekonomike, duke qenë vendi më i varfër i Europës. Së dyti, vendi vuajti për rreth 50 vjet një nga regjimet diktatoriale më të egra në bllokun komunist, duke vuajtur kështu ndërprerjen e çdo lloj lidhje ekonomike, politike dhe kulturore me botën e jashtme për dekada të tëra. Vetë izolimi ndërkombëtar, ndaloi kategorikisht lëvizjen e lirë të njerëzve dhe informacionit dhe nuk lejoi ekzistencën e asnjë organizate ndërkombëtare në vend deri në vitin 1991. Dhe pa dyshim, trashëgimia historike e Shqipërisë nga Perandoria Otomane dhe nga komunizmi, janë faktorë

Bogdani, M., Loughlin, J. (2004), Shqipëria dhe Bashkimi Europian. Integrimi Europian dhe Perspektiva e Pranimit, DAJTI 2000, 32-33
 Perspektiva evropiane e Shqipërisë: perceptime dhe realitete 2014, Albanian Institute for International Studies, 8

¹“Transformimi i Madh: 25 vjet përvoja shqiptare e tranzicionit dhe demokratizimit”

influenca në pengimin e një tranzicioni të saj të suksesshëm drejt një demokracie liberale moderne³ e rrjedhimisht edhe vështirësimin e procesit të aderimit të saj në familjen e madhe europiane përfaqësuar nga Bashkimi Europian.

3. Mangësitë e kushtetutës shqiptare kundrejt standardeve europiane

Kriteret për anëtarësimin në Bashkimin Europian, të ashtuquajturat kriteret e Kopenhagenit, u formuluan nga Këshilli i Europës në 1993 dhe janë sanksionuar në Nenet 6 (1) dhe 49 të Traktatit të Bashkimit Europian. Këto kriterë përfshijnë:

- Kriteret politike, të cilat kërkojnë stabilitetin e institucioneve të cilat garantojnë demokracinë, zbatimin e ligjit, të drejtat e njeriut si dhe mbrojtjen dhe respektin e minoriteteve
- Kriteret ekonomike, që kërkojnë ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale si dhe kapacitetin për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut të BE-së
- Aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, duke përfshirë bashkëngjitjen me bashkimin politik, ekonomik dhe monetar.

Një kriter shtesë, i cili është shtuar në mbledhjet e mëpastajme të Këshillit Europian është:

Rëndësia jo vetëm e inkomporimit të “*acquis communautaire*” në legjislacionin kombëtar, por gjithashtu sigurimi i zbatimit të tij efektiv përmes strukturave të duhura administrative dhe juridike⁴.

Pikërisht në analizën e inkomporimit të këtyre kriterëve dhe standardeve demokratike dhe europiane në legjislacionin tonë të brendshëm, Kushtetutën, do të bazohet edhe ky studim. Domosdoshmëria e inkomporimit të këtyre parimeve dhe standardeve demokratike në legjislacionin tonë, fillon që nga akti themelor i shtetit që është kushtetuta. E në fakt, për shtetin shqiptar, kjo sfidë ka qenë dhe vazhdon të mbetet e dyfishtë, për sa kohë synimi për demokratizim përkon edhe me domosdoshmërinë e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë europian. Pikërisht në këtë pikë, mangësitë e legjislacionit shqiptar janë të konsiderueshme, për t'u ndalur kështu në aktin themelor të shtetit, në aktin konform të cilit duhet të jenë gjithë aktet e tjera, në atë që francezët me të drejtë e quajnë si *la tête de chapitre*, pra kushtetutën shqiptare. Pra, në një vështrim të përgjithshëm, duket se ajo “është përpjekur” për demokratizim, por në një lexim më të hollësishëm përsëri shfaqen domosdoshmëri për t'u plotësuar në këto aspekte.

Një rast që ja vlen për t'u trajtuar është fusha e barazisë gjinore. Bashkimi Europian ka krijuar një legjislacion të rëndësishëm në fushën e barazisë gjinore: 40 vjet pas marrëveshjes së Romës, Samiti i Esenit (dhjetor 1994), u përqendrua në identifikimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat si një, detyrë parësore⁵ e BE-së, të cilat janë konsideruar si kusht për zhvillimin ekonomik të tregut të brendshëm. Si rrjedhojë, në ditët e sotme, promovimi i mundësive të barabarta gjinore është një element qendror në politikën dhe planifikimin ekonomik të Bashkimit Europian dhe shteteve anëtare në veçanti. Traktati i të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian e garanton si një parim themelor barazinë midis burrave dhe grave.

Ndërkaq në Kushtetutën Shqiptare i vetmi nen që shprehet në këtë fushë, është neni 18 i saj, i cili përcakton se:

Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjeje e arsyeshme dhe objektive.

Pra nga një analizë që mund t'i bëhet nenit rezulton se: të gjithë të barabartë përpara ligjit, pa dallim gjinie. Në fakt tepër pak, për një parim kaq të rëndësishëm siç është barazia gjinore. Pavarësisht se ky parim është i sanksionuar edhe në një sërë ligjesh të tjera si: Kodi Penal, Kodi i Punës, Kodi i Familjes, Ligji për Shëndetin Riprodhues, Ligji për një Shoqëri Gjinore të Barabartë, Ligji për Masat Kundër Dhunës në Familje, Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri si dhe Ligji për Parandalimin e Dhunës në Familje; Kushtetuta e Shqipërisë si *la tête de chapitre*, duhet të ketë një rregullim shumë më të detajuar e gjithëpërfshirës të barazisë gjinore mes burrit dhe gruas në të gjitha fushat e jetës.

Ligji europian për ambientin është gjithashtu i mirë detajuar. Numri i përgjithshëm i pjesëve individuale të legjislacionit që përbëjnë në tërësi Ligjin europian për mjedisin vlerësohet të jetë rreth 200, duke mbuluar një gamë të gjerë të sektorëve si: mbrojtja e natyrës, menaxhimi i mbeturinave, kualiteti i ajrit, mbrojtja e ujit dhe kontrolli i ndotjes industriale. Përveç legjislacionit sektorial, legjislacioni horizontal mbulon vlerësimin e ndikimit në mjedis, qasjen e informacionit mjedisor, qasjen në drejtësi dhe pjesëmarrjen publike⁶. Si rrjedhim i detyrimeve ndërkombëtare në çështjet mjedisore edhe Shqipëria ka ratifikuar një sërë konventash ndërkombëtare si: Konventa e Aarhusit e cila garanton të drejtën e publikut për informacion,

³ Bogdani, M., Loughlin, J., 32-33

⁴ Bogdani, M., Loughlin, J., 38-39

Picari, B., (shkurt 2008), Barazia Gjinore. Kusht për integrimin europian, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, 14
Cremona, M. (2013), Pajtuëshmëria dhe Zbatimi i së Drejtës së BE-së, Universum Press, 2013, 77

pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për çështje që lidhen me mjedisin; Konventa e Bernës, për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror europian; Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimet klimatike; Konventa e mbrojtjes dhe e ruajtjes së ujërave ndërkuftarë dhe liqeneve ndërkombëtare; Konventa e Baselit mbi lëvizjen ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre; Konventa e CITES mbi tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër; Protokollin e Kiotos i cili synon uljen e çlirimit të gazrave ndotëse në ajër, etj. E megjithatë Kushtetuta e Shqipërisë ka një frymë shumë të mangët lidhur me këto çështje, të kufizuara vetëm tek ajo çka parashikon neni 56 i saj, sipas të cilit “kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij”. Nga analiza që mund t'i bëjmë këtij neni, del se Kushtetuta sanksionon informimin rreth mjedisit dhe mbrojtjen e tij. Natyrshëm lind pyetja: po veprimtaritë konkrete në lidhje me çështjet mjedisore, nuk mund të parashikoheshin ato në mënyrë më të qartë e të detajuar në Kushtetutën shqiptare? Po të vazhdojmë me analizën tonë, do të mund të thonim se përderisa çështjet e fushës mjedisore gjejnë mbrojtje dhe zbatim në rreth 200 pjesë individuale legjislative europiane, dhe ku Shqipëria ka ratifikuar një gamë të rëndësishme të tyre, a nuk do ishte e mundur që këto çështje të mund të gjenin një rregullim më të përshtatshëm e të plotë edhe në Kushtetutën tonë? Kjo për më tepër paraqet problematikë referuar faktit se Kushtetuta shqiptare nuk e legjitimon individin për ankesë, por i jep atij vetëm të drejtën për t'iu informuar për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e këtij të fundit. E kështu do të mund të vazhdonim arsyetimin tonë, kundrejt mangësive që paraqet kushtetuta shqiptare, në drejtim të demokratizimit, konform standardeve europiane, me nenin 59 të saj ku parashikohen Objektivat Socialë të shtetit. Në një vështrim të parë, ky nen duket gjithëpërfshirës dhe i mirë detajuar si më poshtë vijon:

Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:

punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë;

plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim;

c) standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm;

ç) arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të rinjve, si dhe të personave të pazënë me punë;

d) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;

dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm;

përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët; ë)

zhvillimin e sportit dhe të veprimtarive ripërtëritëse;

f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paafteve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës;

mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe.

Përbushja e objektiveve socialë nuk mund të kërkohej drejtpërdrejt në gjykatë. Ligji përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohej realizimi i këtyre objektiveve.

E megjithatë, edhe këtu kemi mangësinë e radhës, për sa kohë, shteti ynë parashikon këto objektiva sociale të cilat ai thjesht synon t'i realizojë, duke mos marrë kështu përsipër detyrimin për t'i garantuar ato.

Një tjetër nen i Kushtetutës shqiptare, i cili mund të shihet disi me “dysim” në këtë aspekt, është edhe ai i cili parashikon të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pra neni 42 i kushtetutës i cili parashikon shprehimisht se:

Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Referuar paragrafit të parë të këtij neni, jemi dakord me përcaktimin që i bëhet procesit të rregullt duke e cilësuar atë si ligjor dhe jo thjesht gjyqësor. Pra ky është një përcaktim apo parashikim i drejtë dhe më përfshirës se sa do të mund të ishte thjesht procesi i rregullt gjyqësor. E megjithatë, mangësia qëndron në drejtim të elementëve që në tërësi përbëjnë një proces të tillë, duke qenë se ato nuk limitohen thjesht në një gjykim të drejtë dhe publik, si dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Prandaj do të ishte një plotësim standardi i rëndësishëm, pasurimi i neni 42 të kushtetutës shqiptare, me të gjithë elementët në fjalë, duke i inkorporuar shprehimisht ato brenda në nenin përkatës e duke mos i lënë kështu të veçuara në Kushtetutë apo akte të tjera referuese.

4. Konkluzione/ Rekomandime

Arritur këtu mund të pohojmë se ky studim i përbushit objektivat e paracaktuar. Konkluzionet ku u arrit janë:

Shqipëria po has vështirësi në përfundimin e proceseve të tranzicionit, si rezultat i faktorëve politikë, ekonomikë dhe historikë e socialë.

Shih nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Procesi i demokratizimit të Kushtetutës së Shqipërisë konform standardeve europiane, si një proces tejet i rëndësishëm, me ndikim gjithëpërfshirës demokratizues në të gjitha proceset që ndodhin në vend, për vetë rëndësinë që paraqet Kushtetuta e Shqipërisë si Akti Themelor i shtetit, megjithë përpjekjet e bëra, përsëri rezulton i paplotë dhe i pamjaftueshëm.

Ndaj rekomandohet fuqishëm që këto mangësi në procesin e demokratizimit të Kushtetutës shqiptare, për vetë rëndësinë që ajo paraqet, të mund të trajtohen dhe plotësohen sa më shpejt në mënyrë që akti themelor i shtetit të jetë i plotësuar konform të gjitha standardeve europiane, edhe pse kjo mund të kërkonte ndërhyrjen në kushtetutë.

Bibliografia

- Bogdani, M., Loughlin, J. (2004), Shqipëria dhe Bashkimi European. Integrimi European dhe Perspektiva e Pranimit, DAJTI 2000
Cremona, M. (2013), Pajtueshmëria dhe Zbatimi i së Drejtës së BE-së, Universum Press
Gruda, A., Guxholli, A., Filipi, Gj. (2008), Barazia gjinore në procesin e integritimit european. Shifra dhe fakte, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
Perspektiva evropiane e Shqipërisë: perceptime dhe realitete 2014, Albanian Institute for International Studies
Picari, B., (shkurt 2008), Barazia Gjinore. Kusht për integrimin european, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
Suti, E., Shehaj, E., Bogdanovski, A., Djukic, A., Pintea, A., (March 2010), ACHIEVING EU CANDIDATE STATUS. A regional perspective from Albania, Macedonia, Serbia, Romania,
Southeast Europe and the European Union-Leadership, Development Programme, IV Edition
Legjislacion dhe akte ndërkombëtare:
Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut

FUNKSIONIMI I PROGRAMIT PËR ZHVILLIM PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE NË KOSOVË (PËRSHKRIM I GJENDJES PËR NJË PERIUDHË TË FUNKSIONIMIT TË PROGRAMIT¹)

ARBËRORE BERISHA – BICAJ, DOKTORANTE

ABSTRAKT

Në bazë të kërkesave të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, të vitit 2006, në përputhje me Ligjin për Arsimin Fillor dhe të Mesëm, përmes një udhëzimi administrativ, të gjithë mësimit në Kosovë, do të duhej t'i nënshtroheshin procesit të kualifikimit universitar katërvjeçar, për t'u konsideruar të kualifikuar për ushtrimin e profesionit të mësuesit. Pikërisht për këtë arsye, në kuadër të Universitetit të Prishtinës, u themelua programi me emërtime të ndryshme gjatë periudhave të funksionimit, dhe tash së fundmi i ashtuquajtur Programi Avancimi i Kualifikimit të mësimit në Kosovë, me implementim në Fakultetin e Edukimit. Qëllimi i hulumtimit është të reflektojë për funksionimin e Programit Avancimi i Kualifikimit të mësimit në Kosovë, duke përfshirë dy fazat e programit (me programet lëndore) dhe procesin e mbarëvajtjes së mësimit. Janë analizuar rregulloret e programit, korniza e hartimit të syllabusëve, si dhe raportet e Këshillit Drejtues të programit etj., por jo edhe këndvështrimi i vijuesve të programit dhe gjenjda reale konkrete. Do të thotë, gjetjet kanë rrjedhur nga rishikimi i literaturës, analiza e metodave teorike dhe e dokumentacionit pedagogjik. Nga këto të dhëna, vërehet se kurset e ofruara në program, ofrojnë metodologjitë më të avancuara të mësimit dhe mësimit dhe se programi është i vetmi program për zhvillimin profesional të të gjithë mësimit në Kosovë, në mbështetje me standardet e Procesit të Bolonjës. Aktivitetet e programit bazohen në mësimit aktiv në praktikën e mësimit, në mësimit të cilët zhvillohen profesionalisht në përputhje me standardet e vendosura nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë. Nga rezultatet e këtij hulumtimi, mund të konkludojmë se programi është mjaft i dobishëm dhe cilësor, që shpie drejt përfitimit të njohurive të reja dhe zhvillimit profesional të të gjithë mësimit në Kosovë.

Fjalë kyç: Mësimit, Programi për kualifikim në shërbim, Fakulteti i Edukimit, Arsimit gjatë gjithë jetës.

Punimi pasqyron gjendjen e programit deri në fund të vitit 2012
Rezultatet e fituara nga hulumtimi kanë dalë nga dokumentacioni përkitazi me funksionimin e programit. Të njëjtat mund të krahasohen me punimin e doktoratës së autores, dhe të shikohet gjendja reale

Hyrje

Qysh në vitin 2001, kur kishte filluar implementimi i Programit kanadez për Aftësimin e Mësimdhënësve kosovarë (KEDP) në Kosovë, flitej për nevojën e një programi për avancim dhe kualifikim të mësimdhënësve. Në këtë kontekst, qëllimi i këtij programi, do të ishte fillimi i zbatimit të qasjeve të reja të mësimdhënies dhe mësimxënies me në qendër nxënësin. Kjo, u fuqizua, pasi që Këshilli për Shqyrtimin e Aftësimit të mësimdhënësve (KSHAM), në kuadër të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (MASHT) miratoi Standardet e Programeve për Përgatitjen e Mësimdhënësve, në vitin 2004. Standardet e reja, parashihnin studime 4 vjeçare universitare, andaj u krijua një qasje e re për të gjithë mësimdhënësit që kishin përfunduar Shkollën e Lartë Pedagogjike (SHLP). Në këtë mënyrë, u paraqit nevoja për kualifikime plotësuese të mësimdhënësve kosovarë, dhe njëherit për themelimin e një programi, që do të ndihmonte për të përmirësuar pasqyrën e

kualifikimeve të mësimdhënësve në shërbim dhe njëherit në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies: *Një program i tillë për kualifikim të mësimdhënësve, dallohej nga programet e tjera trajnuese të mësimdhënësve në shërbim, që organizonin organizatat joqeveritare, me faktin që do të ofrohej në nivel institucional, dhe i takonte arsimit formal.*

Programi Pa Shkëputje nga Puna – Në përputhje me nevojën për rikualifikim të mësimdhënësve, në vitin 2006, në kuadër të Fakultetit të Edukimit filloi punën Programi Pa Shkëputje nga Puna (PAPSHP), duke funksionuar në katër qendra të këtij fakulteti, në qendrën e Prishtinës, të Gjilanit, të Prizrenit dhe atë të Gjakovës. Ishte ky i vetmi dhe i pari program në Kosovë, që jetësonte konceptin dhe filozofinë e Arsimit gjatë gjithë jetës. Njëherit, programi rezultonte nga bashkëpunimi institucional, në mes të Universitetit të Prishtinës (UP) dhe Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (MASHT), me nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit. Studentët, të cilët do t'i nënshtroheshin këtij programi, do të fitonin titullin *Baçellor i përgjithshëm i edukimit*, dhe në fund të programit, ai do të duhej të grumbullonte 240 kredi (ECTS)². Numri i përgjithshëm i studentëve të përfshirë në program, gjatë kësaj faze, arriti në afërsisht **650** studentë, të cilët diplomuan në shtator të vitit 2009!

Që nga atëherë, programi, edhe pse kaloi nëpër shumë vështirësi, arriti të mbijetojë me shumë sukses, së pari falë entuziazmit të mësimdhënësve kosovar, pastaj falë angazhimit dhe punës së stafit akademik dhe menaxherial të programit.

Në qershor të vitit 2010, MASHT dhe UP, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit, për vazhdimin e programit, i cili do të vazhdonte të funksiononte me një emërtim të ri, si programi Avancimi i Kualifikimit të Mësimdhënësve (AKM). Qëllimi i MASHT dhe UP, për funksionalizimin e këtij programi, ishte pikërisht barasvlerësimi dhe ngritja e kualifikimit të mësimdhënësve kosovar, për të plotësuar njëherit objektivat e Procesit të Bolonjës.

Funksionimi dhe politikat e Programit Avancimi i Kualifikimit të Mësimdhënësve (AKM)

Për dallim nga programi paraparak, i cili ofronte vetëm programin parashkollor dhe atë fillor, programi Avancimi i Kualifikimit të Mësimdhënësve, ofronte edhe programet lëndore. Gjithashtu, një çështje tjetër që e dallonte programin AKM nga PAPSHP, ishin kurset e ofruara për vijuesit. Në programin paraparak ofroheshin kurse metodologjike dhe profesionale, ndërsa në AKM, kurset ishin kryesisht akademike. Fillimisht, AKM startoi me 5 programe, përfshirë edhe komunitetin turk dhe boshnjak në qendrën e Prizrenit, duke u zgjeruar në 10 programe, të gjitha programet me të cilat dispononte edhe Fakulteti i Edukimit (FE), në programet e para shërbimit.

Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit, MASHT-UP, të qershorit 2010, dhe në bazë të Udhëzimit administrativ të MASHT-it, 16/2005, përkitazi me standardet e programeve për përgatitjen e mësimdhënësve gjatë studimeve, programi vazhdoi punën, duke qenë në shërbim të realizimit të parimeve dhe orientimeve të Kornizës Kombëtare të Kurrikulimit (KKK). Me këtë program arrihet të sigurohet avancimi i kualifikimit të mësimdhënësve, të cilët posedonin diplomë të SHLP 2 vjeçare në Baçellor i Edukimit (varësisht nga profili i studimeve të vijuesit). Pikërisht në këtë pikë, në mes të tjerash, dallohej programi AKM nga ai paraparak, i cili shpiente te titulli Baçellor i përgjithshëm i Edukimit. Për të arritur këtë titull, vijuesit duhet të plotësonin 240 ECTS, për të qenë të barasvlerëshme me programet e parashërbimit në Fakultetin e Edukimit. Ndërsa, ajo që e dallonte mësimdhënësit që do t'i nënshtroheshin programit për kualifikim të mësimdhënësve, në këtë aspekt, ishte fakti që llogaritja e kreditave (ECTS-ve) në këtë program do të bëhej duke marrë për bazë kualifikimin e mësimdhënësve me shkollim dyvjeçar (SHLP) që konsiderohej të jetë i barasvlerëshëm me 120 ECTS, dhe nisur nga kjo gjendje, për të fituar titullin Baçellor katërvjeçar, kësaj kategorie të mësimdhënësve, i nevojiten edhe 120 ECTS të tjera!³

Edhe pse, Memorandumi i Bashkëpunimit, parashihte që programi të implementohej nga Universiteti i Prishtinës, në bashkëpunim me të gjitha njësitë akademike, barra më e madhe për implementim të programit i takonte Fakultetit të Edukimit, duke pasur shtrirje në katër qendra të Fakultetit të Edukimit. Në anën tjetër, programi AKM për të zbatuar njërën ndër kriteret e Memorandumit, vazhdonte bashkëpunimin edhe me njësitë e tjera akademike të Universitetit të Prishtinës, duke shfrytëzuar për zhvillimin e mësimin, lokalet e disa prej Fakulteteve, si: të Fakultetit Filozofik, Fakultetit Filologjik,

Rexhaj, Xhavit. 2011. Kualifikimi i mësimdhënësve të Kosovës pa shkëputje nga puna dhe standardet përkatëse evropiane, Prishtinë: Punim në dorëshkrim. f. 47-48.

Po aty, f. 49

Bazuar në Raportin për KSHLM (14.06.2011), hartuar nga drejtoresha Linda Grapci – Kotori, f. 1-2.

dhe atij të Shkencave Matematiko-Natyrore!⁴ Gjithashtu, në qendrën e Prizrenit, në pamundësi të shfrytëzimit të lokaleve të Fakultetit të Edukimit, shfrytëzohen lokalet e gjimnazit “Gjon Buzuku”, derisa në dy qendrat e tjera, në Gjilan dhe në Gjakovë, shfrytëzoheshin lokalet e FE-së.⁵

Faza e parë e AKM-së

Implementimi i fazës së parë të programit filloi në muajin nëntor të vitit 2010! Programi AKM, funksionoi dhe u zbatua sipas kësaj ecurie:

Politikat caktoheshin nga Këshilli Drejtues i programit (në përbërje nga përfaqësues të UP, MASHT dhe FE),
 Organizimin e mësimit e udhëheqin koordinatorët dhe drejtori i AKM,
 Rishikimi i kurrikulave bëhej nga grupi i caktuar i ekspertëve,
 Vazhdoi procedura e rishikimit të programeve,
 Shpallja e konkursit për stafin akademik (në web faqen e Universitetit të Prishtinës),
 Caktimi i afateve kohore për përgatitjen dhe dorëzimin e syllabusëve nga mësimit në AKM,
 Përcaktimi i mekanizmave për sigurimin e cilësisë,
 Ndërlidhja e të gjitha hallkave për sigurimin e cilësisë dhe mbarëvajtja e procesit mësues, në bashkëpunim me koordinatorët e të katër qendrave;

Gjithë vendimet e marra nga anëtarët e Këshillit Drejtues (KD) të programit, ishin në mbështetje me Memorandumin e Mirëkuptimit dhe përkitazi me këtë, KD hartoi rregulloren e punës dhe rregulloren e studimeve në programin e AKM-së, duke u bazuar në Udhëzimin administrativ të MASHT-it 16/2005, sipas të cilit funksiononte programi, deri në hartimin e rregullores.⁶ Për të pasur më të qartë natyrën e funksionimit të programit AKM, në vazhdim, janë përmendur disa nga kriteret relevante, nga rregullorja e punës.

Kriteret për angazhimin e mësimit në AKM: Përzgjedhja e stafit akademik, bëhej në përputhje me Statutin e Universitetit të Prishtinës. Procedura e angazhimit, ishte gjithashtu, në përputhje me ato të UP-së. Në bazë të konkursit intern në web-faqen e Universitetit të Prishtinës, mësimit në AKM kishin mundësi aplikimi, ndërsa përzgjedhja bëhej nga Këshilli Drejtues i programit. Duhet përmendur se, stafi akademik i përfshirë në program, i takonte të gjitha njësive akademike të UP-së, duke qenë me prioritet stafi akademik i FE-së.

Kriteret për përzgjedhjen e vijuesve: Duke u nisur nga fakti që programi financohej nga MASHT, edhe përzgjedhja e kandidatëve vijues në program, do të bëhej nga organet kompetente të MASHT dhe nga kriteret e përcaktuara nga vet MASHT. Në këtë mënyrë, zyra përgjegjëse për trajnimin e mësimit në AKM, në bashkëpunim me Drejtorinë komunale për arsim, ka bërë përzgjedhjen e vijuesve, sipas kriterëve të përcaktuara paraprakisht, duke i proceduar më tutje listat në zyrën e AKM-së, në të katër qendrat. Procesi i mëtutjeshëm ka vazhduar në Administratën Qendrore të UP-së, konkretisht në zyrën për shërbim të studentëve, duke u regjistruar dhe pajisur me ineksa, të gjithë vijuesit. Në këtë pikë, është vërejtur numër i madh i vijuesve në AKM, gjë që ka reflektuar në një tregues pozitiv për implementimin e programit.⁷ Përndryshe, në programin paraprak, përzgjedhja bëhej nga anëtarët e Këshillit Drejtues, përmes aplikimit, në bazë të konkursit të shpallur nga UP.

Monitorimi i procesit mësues: Në mesin e procedurave të tjera për sigurimin e cilësisë brenda programit, bëhej edhe monitorimi i rregullt i procesit mësues, nga anëtarët e KD. Gjithashtu, në përfundim të semestrit të pestë, të fazës së parë të mësimit në AKM, është bërë monitorimi i jashtëm nga zyra për zhvillim akademik pranë Universitetit të Prishtinës. Nga rezultatet e këtij vlerësimi del se tërë procesi në program është zhvilluar me një seriozitet të plotë (përfshirë katër qendrat), ku vlerësimi i mësimit në AKM nga ana e vijuesve është afërsisht 90%.⁸ Mësimit në AKM janë vlerësuar, në aspektin e punës cilësore, përdorimit të metodave të reja ndërvetë të mësimit, pjesëmarrjes së rregullt në mësime etj.

Monitorimi i brendshëm është aplikuar me qëllim të:

Kontrollimit dhe raportimit për standardet e kualitetit të mësimit dhe vijueshmërisë të studentëve,
 Identifikimit të anëve të dobëta dhe ato të fuqishme duke ndikuar në përmirësimin e tyre,
 Sigurimit të aktiviteteve të duhura për kompensimin e orëve të humbura,
 • Ndërtimit të një sistemi të informatave të cilat janë të nevojshme për vlerësimin periodik të programit,
 Identifikimit dhe përhapjes së praktikave të mira;

Marrë nga Raporti për gjendjen aktuale të të diplomuarve në AKM, hartuar nga Dr.sc. Linda Grapci – Kotori, Prishtinë 2012, f.1.

Marrë nga Raporti për KSHLM (14.06.2011), hartuar nga drejtoresha Linda Grapci – Kotori, f. 3.

Bazuar në Raportin për KSHLM (14.06.2011), hartuar nga drejtoresha Linda Grapci – Kotori, f. 3.

Marrë nga Raporti për gjendjen aktuale të të diplomuarve në AKM, hartuar nga Dr.sc. Linda Grapci – Kotori, Prishtinë 2012, f. 3-4.

Marrë nga Raporti për gjendjen aktuale të të diplomuarve në AKM, hartuar nga Dr.sc. Linda Grapci – Kotori, Prishtinë 2012, f. 3.

Procedura e monitorimit, ka kaluar nëpër këta hapa:

Monitorimin javor ishte obligim i të gjithë anëtarëve të Këshillit Drejtues të programit të AKM-së, Janë monitoruar 25 kurse dhe gjashtë programe sipas raportit të prezantuar nga koordinatorët, Gjatë monitorimit është plotësuar formulari i cili është nënshkruar nga koordinatorët e AKM në secilën qendër përkatëse të F. të Edukimit.

Zhvillimi i mësimit

Organizimin e mësimit, e përcaktonte statusi i vijuesit, në përputhje me kreditë (ECTS). Derisa vijuesi kishte arritur 120 ECTS, gjatë shkollimit paraprak në SHLP, atij i nevojiteshin 120 ECTS të tjera, për të përbushur 240 ECTS-të e kërkuara për të qenë i kualifikuar për mësime të mësimdhënies (përlllogaritja e ECTS-ve, është në përputhje me Deklaratën e Bolonjës dhe adekuat me ato të Universitetit të Prishtinës). Për t'u arritur kjo, mësimi zhvillohej në tre semestra, me gjithsej 14-15 javë mësimi, 5 kurse me nga tri orë mësimore (gjithsej 42 orë) për semestër, dhe semestri i fundit (i katërt) ishte i paraparë për përgatitjen e temës së diplomës. Secili kurs, përmban 6 ECTS, dhe brenda 14-15 javëve mësimore, 13 javë ishin të parapara për zhvillimin e leksioneve, dhe dy javë të tjera përfshinin vlerësimin e njohurive të vijuesve.

Vlerësimi

Provimet organizohen në fund të përfundimit të kursit dhe sipas orarit të rregullt të provimeve. Për vlerësimin intermediar të njohurive, parashiheshin teste sumative, ndërkohë që vlerësimi formativ aplikohet gjatë gjithë procesit të mësimeve dhe mësimit, në vazhdimësi. Përndryshe, në fund të kursit, me kombinimin e pikëve të fituara, nga testet sumative, vlerësimet formative, shkallës së pjesëmarrjes së vijuesit në mësime, është fituar nota përfundimtare. Shkalla e kalueshmërisë së vijuesve arrinte 80%.⁹

Programet e ofruara

Në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit, në program do të ofrohen 30% kurse pedagogjike, ndërsa pjesa tjetër e kurseve që do të ofrohen janë kurse akademike, duke u bazuar në nevojat e mësimeve për ngritjen e tyre profesionale.¹⁰

Programet e ofruara në AKM (të akredituara paraprakisht nga Agjencia e Akreditimit), u hartuan duke u bazuar në programet e mëhershme të SHLP (dy vjeçare) dhe programet aktuale në Fakultetin e Edukimit, gjithmonë në pajtim me Udhëzimin Administrativ 16/2005 të MASHT për përgatitjen e mësimeve. Sa i përket fazës së parë të funksionimit të AKM, viti akademik 2010/11 programet që janë ofruar në atë kohë, janë:

- Programi parashkollor (vetëm në Gjilan)
- Programi Fillor
- Programi Matematikë - Informatikë
- Programi Teknologji – Informatikë
- Programi Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
- Programi Gjuhë dhe Letërsi Angleze

Numri i përgjithshëm i studentëve në AKM, të përfshirë në fazën e parë të mësimeve në AKM arrinte në **1067**.¹¹ Vijuesit e përfshirë në këtë fazë të mësimeve në AKM, arritën të diplomojnë në periudhën qershor-korrik 2012!

Faza e dytë e AKM-së

Vazhdimi i programit me fazën e dytë të mësimeve ka startuar më 10 Mars të vitit akademik 2011/2012, me po të njëjtën procedurë. Ajo që e dallonte fazën e dytë, nga faza e parë ishte, shtimi i numrit të programeve (edhe me 4 programe të tjera), si në vijim:

- Programi Fizikë - Kimi
- Programi Biologji – Kimi

Marrë nga Raporti për gjendjen aktuale të të diplomuarve në AKM, hartuar nga Dr.sc. Linda Grapci – Kotori, Prishtinë 2012, f. 2.

Po aty, f. 4.

Bazuar në Raportin për KSHLM (14.06.2011), hartuar nga drejtoresha Linda Grapci – Kotori, f. 3-4.

Programi Histori – Edukatë qytetare
Programi Gjeografi – Edukatë qytetare.

Ndërsa, numri i studentëve, në këtë fazë arrinte në **1970**.¹² Duhet potencuar se vijuesit e kësaj faze të AKM-së, janë në proces e sipër të mësimit, që do të thotë, nuk kanë arritur të diplomojnë!

Në bazë të dokumentacionit, dhe të dhënave që disponon zyra e AKM, numri i përgjithshëm i studentëve të diplomuar, që nga fillimi i implementimit të programit, arrin në **2620!** Ndërsa, sipas informatave nga zyra për trajnimin e mësimit në MASHT, numri i mësimit, që do të nënshtrohen programit në të ardhmen është **1828!**

Përfundime

Sipas të dhënave në dispozicion, AKM është i vetmi program formal për zhvillimin profesional të të gjithë mësimit në Kosovë, në mbështetje me standardet e Procesit të Bolonjës. Në aspektin e funksionimit të përgjithshëm të programit, shihet se politikat e programit, funksionojnë në përputhje me Udhëzimin Administrativ të MASHT 16/2005, statutin e UP-së, dhe rregulloret për punë, të programit. Sa i përket cilësisë, AKM dallohet me mekanizma të posaçme si për angazhimin e stafit akademik, ashtu edhe për sigurimin e cilësisë së mësimit. Nga këndvështrimi lidhur me sigurimin e cilësisë në ofrimin e kurseve, mund të themi se programi ofron kurset me metodologjitë më të avancuara të mësimit dhe mësimit. Kështu që, një program cilësor si AKM, shpie drejt përfitimit të njohurive të reja dhe zhvillimit profesional të të gjithë mësimit në Kosovë. Kjo konsiston në atë se, këto njohuri dhe aftësi të reja që përfitojnë mësimit në program, janë të nevojshme për arritjen e standardeve të larta akademike në fushat ku ata punojnë. Në anën tjetër, ekziston një bashkëpunim transparent dhe shumë konstruktiv në mes të AKM-së dhe të FE-së.

Nga gjithë kontributi i dhënë, qoftë nga stafi mësimit në program, ashtu edhe nga stafi menaxherial dhe grupi për hartimin e politikave, në këtë rast KD, për një funksionim cilësor të programit, pritet përfitim i dobishëm nga ana e vijuesve, qoftë në absorbimin e njohurive të reja, por edhe në reflektimin e atyre rezultateve, në punën e tyre në klasë. Një gjë e tillë, apo konkretisht pasqyrimi i efektit të rezultateve të programit, në procesin mësimit në shkolla, pritet menjëherë pas përfundimit të studimeve në program.

Rekomandime

- Të krijohen kushte për vazhdimin e funksionimit të programit, për përfshirjen e pjesës tjetër të mbetur të mësimit në program;
- Të vazhdojë bashkëpunimi me Fakultetin e Edukimit;
- Të zhvillohet një studim i mësimit që kanë përfunduar studimet, përkitazi me suksesin e treguar në punën e tyre, qoftë në mësimit dhe në mësimit;
- Të hulumtohet lidhur me nivelin e mësimit së ofruar në program dhe me nivelin e kurseve të ofruara;
- Të zhvillohet hulumtim me vijues lidhur me rëndësinë, dobitë dhe përfitimet nga programi;
- Të krijohet mundësia e përfshirjes në program, edhe për vijuesit, të cilët kanë përfunduar SHLP-në, por që nuk janë të inkadruar në procesin mësimit!

REFERENCAT

- Raporti për KSHLM, 14.06.2011, hartuar nga Linda Grapci – Kotori, Prishtinë.
- Raporti për gjendjen aktuale të të diplomuarve në AKM, 2012, Prishtinë.
- Rexhaj, Xhavit. 2011. Kualifikimi i mësimit në Kosovë pa shkëputje nga puna dhe standardet përkatëse evropiane, Prishtinë: Punim në dorëshkrim.
- Raportet për mbarëvajtjen e mësimit, hartuar në vazhdimësi nga koordinatoret e programit.

Sipas dokumentit të zyrës, nga raportet e koordinatoreve: Raportim rreth procesit të mbarëvajtjes së mësimit në semestrin e V-të, të gjeneratës së dytë në programin e AKM-së.

E DREJTA E JETËS “NJË ANALIZË E DINAMIKAVE TË KËSAJ TË DREJTE”

AFERDITA TEP SHI

Doktorante Fakulteti Juridik, Universiteti Europian i Tiranës

ABSTRAKT

E drejta për jetën është padyshim e drejta më e rëndësishme njerëzore nga gëzimi i së cilës burojnë dhe një sërë të drejtash të tjera themelore të ndërvarura. Ajo përbën një të drejtë të paderogueshme, të pandashme të patjetërsueshme e lidhur ngushtë me qenien njerëzore.

Jeta është një vlerë e pa krahasueshme dhe e pa zëvendësueshme me asnjë vlerë tjetër, sado e shtrenjtë dhe e çmuar që mund të jetë ajo. E drejta për të jetuar është një institut i gjerë, në të cilin përfshihen aspekte që kanë të bëjnë me sigurinë globale e kombëtare, shëndetësorë, ushqimore, shpirtërore, mjedisore, në punë dhe për punë, rrugore, pasurore, banesore, seksuale, personale, ligjore etj. Këto aspekte lidhen direkt ose indirekt, jo vetëm me dinjitetin dhe cilësinë e jetës, por edhe me të drejtën për të jetuar.

Jeta e personit mbrohet me ligj. Në këtë mënyrë është sanksionuar koncepti juridik i mbrojtjes së jetës njerëzore në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ky formulim shpreh qartë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen e jetës së njeriut, e cila përbën një vlerë kushtetuese. E drejta për jetën paraqitet në Kushtetutë, si një vlerë, nga e cila burojnë të gjitha të drejtat e tjera. Parimet themelore të mbrojtjes së jetës gjejnë mbështetje të plotë në këto dispozita. Jeta është një e drejtë, atribut fundamental i qenies njerëzore dhe kur kjo jetë hiqet, apo merret në çfarëdo mënyre, njeriu në të njëjtën kohë eliminohet si mbartës të drejtash dhe detyrimesh.

Subjektet që detyrohen nga ligji për të garantuar të drejtën për të jetuar janë të shumtë dhe realizojnë mbrojtje të posaçme, të veçantë, konkrete, apo të përgjithshme. Në krye të këtyre subjekteve qëndron Shteti. Për këtë qëllim ai ndërton, institucionalizon, modernizon dhe monitoron mekanizmat, strukturat kapilare në çdo sektor të jetës, mjetet dhe metodat, kushtet dhe mundësitë për funksionimin efektiv të tyre. Në kuadrin e realizimit të këtij misioni merr përparësi parandalimi i kriminalitetit kundër jetës.

Fjalë kyç: Jeta, aborti, vdekja, shteti, eutanazia, mbrojtja.

Hyrje

E drejta për të jetuar, konsiderohet si një nga të drejtat më themelore, pasi ajo ju jep start, jetë dhe materializon të gjitha të drejtat e tjera. Jeta është një vlerë e pa krahasueshme dhe e pa zëvendësueshme me asnjë vlerë tjetër, sado e shtrenjtë dhe e çmuar që mund të jetë ajo. E drejta për të jetuar është një institut i gjerë, në të cilin përfshihen aspekte që kanë të bëjnë me sigurinë globale e kombëtare, shëndetësore, ushqimore, shpirtërore, mjedisore, në punë dhe për punë, rrugore, pasurore, banesore, seksuale, personale, ligjore etj. Këto aspekte lidhen direkt ose indirekt, jo vetëm me dinjitetin dhe cilësinë e jetës, por edhe me të drejtën për të jetuar.

Subjektet që detyrohen nga ligji për të garantuar të drejtën për të jetuar janë të shumtë dhe realizojnë mbrojtje të posaçme, të veçantë, konkrete, apo të përgjithshme. Në krye të këtyre subjekteve qëndron Shteti. Për këtë qëllim ai ndërton, institucionalizon, modernizon dhe monitoron mekanizmat, strukturat kapilare në çdo sektor të jetës, mjetet dhe metodat, kushtet dhe mundësitë për funksionimin efektiv të tyre. Në kuadrin e realizimit të këtij misioni merr përparësi parandalimi

i kriminalitetit kundër jetës. Suksesi i shtetit nuk mund të matet me nivelin e masave për përballimin e situatave, apo ngjarjeve kriminale që shoqërohen me vdekje, por me reagimin për parandalimin e tyre në kohë.

Punimi do të ketë si synim kryesor të analizojë të drejtën e jetës në kuadrin e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, duke dhënë kuptimin e të drejtës për jetën, duke analizuar të drejtën e abortit, dënimin me vdekje dhe eutanazinë të cilat janë trajtesa me interes dhe shumë të debatueshme në shoqërinë tonë. Sigurisht përfundimet do të synojnë të bëjnë një përmbledhje të punimit duke ndarë në pika aspektet kryesore të analizës shkencore të së drejtës së jetës.

Aborti është një çështje sa njerëzore, aq edhe ligjore e morale! Ka të bëjë me zhvillimin e një shoqërie, por edhe me të drejtat e grave. Në të gjithë botën, aborti është një temë delikate që ka hapur shumë diskutime dhe debate të cilat i kanë ndarë njerëzit përgjithësisht në dy grupe kryesore. Të parët janë pro zgjedhjes dhe janë dakord që aborti të jetë i ligjshëm kur nëna e kërkon atë, dhe të dytët pro jetës që janë kundër ndërprerjes së shtatzënisë dhe mbrojnë fetusin si një qenie njerëzore që ka të drejtë të jetojë. Sipas këtyre të fundit, prindërit nuk duhet të vendosin për jetën e dikujt tjetër, qoftë ky dhe fëmija i tyre, sepse ai është një individ dhe si i tillë duhet të jetë nën proteksionin e ligjit. Ata gjithashtu gjykojnë mjekët që kryejnë abortin, sepse sipas tyre ata theyejnë urdhrat bazë të praktikës mjekësore që janë: “*Mos dëmto*” dhe “*Respekto jetën njerëzore*”.¹

Aborti është shkatërrim i qëllimtë i fetusit në mitër apo çfarëdo lindje para kohe me qëllim që të shkaktohet vdekje e fetusit. Ashtu siç është i dukshëm qartë edhe rezultati i veprimit, qëllimi është që të përfundojë jeta e një krijese të gjallë, që e bën abortin temë kaq të dënueshme moralisht nga shoqëria.

Në asnjë ligj të të drejtave të njeriut nuk ka vend për embrionin. Askund dhe me asgjë s’i është garantuar e drejta për jetë e njeriut në fillimet e jetës. Madje, vrasja, ndalimi i shtatzënisë, hedhja e fetusit/embrionit - *abortimi*, nuk konsiderohet akt penal, akt i pamoralshëm, por e drejtë e gruas që të vendosë për fatin e frytit të saj. Në të njëjtën kohë, edhe pse kjo pohohet e mbrohet nga “*mbrojtësit e të drejtave të njeriut*”, në njërën anë respektohet e drejta e një personi - gruas, e në anën tjetër lejohet, përkatësisht shkelet dhe legalizohet vrasja e njeriut të pafajshëm, embrionit të pambrojtur.

Në Shqipëri kemi Ligj për Abortin dhe kjo sipas mendimit tim është arritje e madhe ligjore për të respektuar të drejtën e gruas që të marrë vendim të pavarur për veten e saj. Në këtë kontekst ligji publik për abortin në shoqërinë tonë është i rëndësishëm sepse ai ka si qëllim që të respektojë në mënyrën e duhur jetën njerëzore, të rregullojë në mënyrën e duhur institucionet me të cilat shoqëria riprodhohet, të garantojë barazinë e plote për gratë dhe t’u përgjigjet kërkesave të arsyes publike duke mënjanuar në të njëjtën kohë efektet dhe doktrinën e tjetër llojta ideologjike apo teologjike që mund të ndikojnë mbi të me argumente të tjera. Baza ligjore dhe praktika zyrtare e realizimit të aborteve në Shqipëri është kompatibël me kërkesat e kohës moderne sipas të cilit çështjet e abortit i vlerëson si vlera politike brenda caqeve të arsyes publike. Me fjalë të tjera sot nuk mundet më në shoqërinë tonë të shtrohet problemi nëse aborti është çështje personale apo çështje publike.

Në këtë punim do të trajtojmë një sërë çështjesh: si e drejta e personit për të zgjedhur vdekjen për shkaqe objektive duke kaluar në plan të dytë të drejtën e jetës. Pasojat juridike të këtij veprimi, e drejta ligjore dhe morale për të kërkuar mbështetje nga persona të tjerë për kryerjen e një veprimi të tillë dhe përgjegjësia e tyre sipas legjislacionit penal. Gjatë këtij punimi kam studiuar një literaturë të gjerë duke e trajtuar çështjen në disa aspekte duke përfshirë përjasjen medicinale, teologjike, sociologjike, dhe sigurisht më së shumti qasjen juridike.

Për ta konkluduar, pasi kam bërë studimin kam vërejtur që legjislacioni shqiptar ka mangësi të theksuara, pasi duke mos dalë me një dispozitë konkrete për Eutanazinë, lë shteg për abuzime lidhur me cilësimin ligjor të veprës duke u shkelur të pandehurve të drejtat e tyre procedurale dhe materiale. Unë mendoj që nëse Shqipëria vendos që të ketë përparësi e drejta e jetës mbi të drejtën e zgjedhjes së individit, të dalë me një dispozitë konkrete për Eutanazinë duke mos parashikuar një sanksion të rëndë, për shkak të vetë rrethanave në të cilat kryhet vepra. Më mire se kaq do të ishte të merrej shembulli nga disa vende shume të zhvilluara dhe demokratike siç janë Gjermania, Belgjika, Holanda etj, të cilat e kanë depenalizuar këtë veprë.

E drejta për të jetuar

Çdo kushtetutë demokratike synon të mbrojë dhe garantojë të drejtat themelore të qytetarëve të vet. Në të drejtat themelore të njeriut përfshihet edhe e drejta për të jetuar, e cila do të jetë një nga të drejtat më të rëndësishme për secilin nga ne. Kjo e drejtë duhet të mbrohet dhe në një farë mënyre të garantohet nga Kushtetuta e re.

Dr. S. Aksoy. Përkthyer nga anglishtja nga Avni Lecaj në revistën Vepra

"Transformimi i Madh: 25 vjet përvoja shqiptare e tranzicionit dhe demokratizimit"

E drejta e jetës mbrohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, disa akte ndërkombëtare, si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e OKB (1948), Konventa Europiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e Këshilli i Europës (1950), si dhe Kodi Penal (nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 81, 82, 83).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ashtu si edhe të gjitha kushtetutat e tjera të vendeve demokratike e njohin të drejtën për jetë si të drejtën thelbësore. Neni 21, i Kushtetutës së Shqipërisë në mënyrë të qartë e thotë; *“Jeta e personit mbrohet me ligj”*.²

E drejta për jetë është e drejta kryesore e njeriut. Është krye e drejta e të gjitha të drejtave. Të gjitha të drejtat e tjera janë të lidhur me të. Është e natyrshme që njeriu që nuk jeton, nuk gëzon asnjë të drejtë.

Pra, ç’kuptim do të kishin të drejtat e tjera, e që janë të shumta, pa e pasur të drejtën për jetë?

Askush nuk ka të drejtë t’ia marrë jetën askujt. Madje këtë të drejtë njeriu e fiton që në embrion, në trupin e nënës. Pra është e ndaluar vrasja e frytit, është e ndaluar edhe vrasja e fëmijëve që lindin me të meta të theksuara; të gjymtë, me mungesë organesh apo organe të tepërta, deformime të rënda, po ashtu është e ndaluar edhe vrasja e atij që pa të drejtë quhet *“monstrum”*. Është e ndaluar edhe vrasja e njeriut të diagnostifikuar me çfarëdo lloj sëmundje, qoftë edhe të pashërueshme dhe të pashpresë. Ndalohet edhe vrasja e njeriut për të cilin është edhe krejtësisht e qartë se brenda një kohe të shkurtër do të vdesë. Kushtetuta e Shqipërisë e jep të drejtën e jetës si të drejtë të pamohueshme nga askush. Është e vërtetë se në dispozita kushtetuese gjen edhe të drejtën në dinjitet, në administrim të trupit të vet nga secili, por e drejta për jetë është e garantuar. Ajo nuk mund të tjetërsohet.³

Secili shtet dhe secili legjislacion, jetës i ka organizuar edhe mbrojtje juridike-penale. Edhe Kodi Penal i Shqipërisë në kapitullin e II, në Seksionin I nen emërtimin veprat penale kundër jetës dhe krimet kundër trupit nga neni 76 gjer në nenin 84, ka përkufizuar 11 lloje të veprave penale dhe ka paraparë sanksione penale mjaft të larta për të gjithë kryesit e këtyre veprave penale.⁴

Jeta është një e drejtë, atribut themelor i qenies njerëzore dhe kur kjo jetë hiqet ose merret, në çfarëdo lloj mënyre, njeriu, në të njëjtën kohë, eliminohet si mbartës të drejtash dhe detyrimesh.

Secili nga ne e kupton se sa e rëndësishme është e drejta për të jetuar dhe secili e kupton se çfarë ndiejmë kur e drejta e dikujt privohet nga ndonjë veprim apo situatë që ne e quajmë të padrejtë.

Kushtetutat dhe ligjet variojnë nga njëri shtet tek tjetri dhe po ashtu në të njëjtën kohë secili prej këtyre të fundit ka këndvështrime të ndryshme mbi të drejtën për të jetuar dhe mbi mënyrën se si ajo duhet mbrojtur. Zakonisht, e drejta për të jetuar mbrohet gjithashtu nga Konventat Ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.⁵ Aplikimi i të Drejtës Ndërkombëtare dhe në mënyrë të veçantë aplikimi i traktateve dhe konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat janë specifike dhe i detyrojnë shtetet palë të mbrojnë dhe të garantojnë këto të drejta themelore.⁶

Trajtesa me interes do të jenë gjithashtu edhe disa çështje të debatueshme në shoqërinë tone siç janë *“dënimi me vdekje”*, *“aborti”*, *“eutania”*. Sigurisht përfundimet do të synojnë të bëjnë një përmbledhje të punimit duke ndarë në pika aspektet kryesore të analizës shkencore të së drejtës së jetës.⁷

Aborti

Aborti është një çështje sa njerëzore, aq edhe ligjore e morale! Ka të bëjë me zhvillimin e një shoqërie, por edhe me të drejtat e grave. Aborti, fjalë kjo e cila vjen nga fjala latinisht për lindjen e parakohshme, është debatuar në çdo kulturë, nga Kisha, nga profesioni mjekësor si dhe avokatët dhe gjykatësit në tërësi. Shtatzënia si proces i prolonguar zgjat 270-280 ditë gjegjësisht dhe muaj lunar apo nëntë muaj kalendarik. Ndërprerja e shtatzënisë qoftë spontane (për shkaqe natyrore; gjendja patologjike), apo e dhunshme para javës së 28 deri në javën e 30 të shtatzënisë quhet abortus. Abortuesi dhe fëmijë vrasja janë dy krime të rënda dhe të vrazhda ndaj natyrës, ndaj njerëzimit, ndaj lloji njerëzor dhe shoqërisë, ndaj moralit dhe etikës dhe ndaj vetë gruas.

Në të gjithë botën, aborti është një temë delikate që ka hapur shumë diskutime dhe debate të cilat i kanë ndarë njerëzit përgjithësisht në dy grupe kryesore. Të parët janë pro zgjedhjes dhe janë dakord që aborti të jetë i ligjshëm kur nëna e kërkon atë, dhe të dytët pro jetës që janë kundër ndërprerjes së shtatzënisë dhe mbrojnë fetusin si një qenie njerëzore që ka të drejtë të jetojë. Sipas këtyre të fundit prindërit nuk duhet të vendosin për jetën e dikujt tjetër, qoftë ky dhe fëmija i tyre, sepse ai është një individ, dhe si i tillë duhet të jetë nën proteksionin e ligjit. Ata gjithashtu gjykojnë mjekët që kryejnë abortin, sepse sipas tyre ata thyejnë urdhrat bazë të praktikës mjekësore që janë: *“Mos dëmto”* dhe *“Respekto jetën njerëzore”*.⁸

Ideja e gabuar rreth argumentit antiabort bazohet në ndryshimin ndërmjet pretendimit të saktë shkencor se fetusit është një qenie e gjallë individuale e species Homo sapiens dhe pretendimit etik se fetusit prandaj ka të drejtën e njëjtë për të jetuar si çdo qenie tjetër njerëzore. Me plot bindje mund të argumentojmë se nuk duhet të vrasim kundër vullnetit të tyre dhe qenieve

Neni 21 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

Shih “Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut” Tiranë 2000, Fq 16

Kodi Penal i Shqipërisë

Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e Këshilli i Europës

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e OKB

Shih për më tepër, leksionet e Prof.Dr. Xhezair Zaganjori, për Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2011-2012.

Èho’s Right to Life - Èomen’s Rights and Prenatal Protections under Human Rights and Comparative Laë, http://reproductiverights.org/sites/crr.civicaactions.net/files/documents/RTL_3%2014%2012.pdf.

të vetëdijshme, të cilat duan të vazhdojnë të jetojnë. Mund ta konsiderojmë këtë si një shkelle të autonomisë së tyre, apo një pengim të preferencave të tyre. Mirëpo pse duhet të jetë i gabuar përfundimi i jetës së një qenieje potenciale që mund të bëhet racionalisht i vetëdijshëm përpara se ai të ketë kapacitetin për racionalizëm apo vetëdije?

Ne nuk kemi kurrfarë obligimi që t'i lejojmë çdo qenieje me potencial që të bëhet një qenie racionale ta kuptojë atë potencial. Në rast se vjen deri te një përplasje ndërmjet interesave të supozuara të qenies racionalisht potenciale por tanimë ende jo të vetëdijshme dhe të interesave vitale të një gruaje tashmë racionale, ne duhet të preferojmë gruan secilën herë.

Aborti është e drejta e gruas, dhe ajo nuk është e detyruar të paraqesë arsye ose të mbrojë vendimin e saj për një abort. Aftësia për të ngjizur, mbartur dhe lindur fëmijë është një forcë e fuqishme dhe e qenësishme, ku përfshihen edhe emocione të forta. Vendimi për të vazhduar ose për t'i dhënë fund një shtatzënie ka të bëjë me individët dhe shkencëtarët në shume nivele: ato emocionale dhe etike, teknike dhe mjekësore.

Pra problemi që debatohet lidhur me abortin ka të bëjë me debatin nëse duhet të jetë argument sundues konceptimi i kësaj të drejte për abort në kuadrin e drejtësisë politike dhe të drejtës së gruas për abort duke lënë mënjane çështjen e statusit moral të fetusit të konceptuar. Orientimi liberal i shoqërisë shqiptare nuk ka mundësi të gjejë rrugë të mesme për të bërë ndarje tjetër midis të drejtës së gruas sipas konceptit të drejtësisë politike dhe konceptimeve restriktuese morale dhe fetare për dëmtimin e fetusit deri në atë masë që ai nuk është bërë bebe.

Ajo që paraqet rëndësi në rrafshin e të Drejtave të Njeriut është përcaktimi i momentit se kur fillon të mbrohet jeta, si e drejtë e patjetërsueshme e njeriut. A është ky moment, momenti biologjik i ngjizjes së jetës apo është çasti kur njeriu lind dhe jep shenja jete. Përcaktimi i këtij momenti paraqet rëndësi të veçantë për përcaktimin e statusit që ka fetusin në raport me të drejtën e jetës. Kuptimi i jetës, përgjithësisht jepet si periudha kohore ndërmjet lindjes dhe vdekjes së një personi. “*Periudha kohore e ekzistencës së një personi e vazhdueshme, derisa ndërpritet nga shpërbërja fizike ose vdekja e ndodhur si proces natyral;...*”⁹

Aborti është shkatërrim i qëllimtë i fetusit në mitër apo çfarëdo lindje para kohe me qëllim që të shkaktohet vdekje e fetusit. Ashtu siç është i dukshëm qartë edhe rezultati i veprimit, qëllimi është që të përfundohet jeta e një krijese të gjallë, që e bën abortin temë kaq të dënueshme moralisht nga shoqëria.

Në asnjë ligj të të Drejtave të Njeriut nuk ka vend për embrionin. Askund dhe me asgjë s'i është garantuar e drejta për jetë e njeriut në fillimet e jetës. Madje, vrasja, ndalimi i shtatzënisë, hedhja e fetusit/embrionit - abortimi, nuk konsiderohet akt penal, akt i pamoralshëm, por e drejtë e gruas që të vendosë për fatin e frytit të saj. Në të njëjtën kohë, edhe pse kjo pohohet e mbrohet nga “mbrojtësit e të drejtave të njeriut”, në njërin anë respektohet e drejta e një personi - gruas, e në anën tjetër lejohet, përkatësisht shkelet dhe legalizohet vrasja e njeriut të pafajshëm, embrionit të pambrojtur.¹⁰

Në Shqipëri kemi Ligj për abortin dhe kjo sipas mendimit tim është arritje e madhe ligjore për të respektuar të drejtën e gruas që të marrë vendim të pavarur për veten e saj. Në këtë kontekst ligji publik për abortin në shoqërinë tonë është i rëndësishëm sepse ai ka si qëllim që të respektojë në mënyrën e duhur jetën njerëzore, të rregullojë në mënyrën e duhur institucionet me të cilat shoqëria riprodhohet të garantojë barazinë e plotë për gratë dhe t'u përgjigjet kërkesave të arsyes publike duke mënjeluar në të njëjtën kohë efektet dhe doktrinat e tjetërlllojta ideologjike apo teologjike që mund të ndikojnë mbi të me argumente të tjera.

Ne e kemi tashmë ligjin që legalizon të drejtën e abortit dhe kjo përbën arritje të madhe për gratë dhe qytetërimin tonë. Natyrisht kudo që është hequr ligji që ndalon abortin janë bërë beteja të mëdha kulturore, ideologjike, mjekësore dhe seksuale për ta realizuar këtë të drejtë të vështirë për gratë. Kjo beteje ka pasur në ballë të saj parullën e famshme që besoj se duhet të jetë edhe për filozofinë e familjes dhe grave tona ku filozofia e së cilës është një fëmijë nëse e dua dhe natyrisht edhe kur e dua.

Baza ligjore dhe praktika zyrtare e realizimit të aborteve në Shqipëri është kompatibël me kërkesat e kohës moderne sipas të cilit çështjet e abortit i vlerëson si vlera politike brenda caqeve të arsyes publike. Me fjale të tjera sot nuk mundet më në shoqërinë tonë të shtrohet problemi nëse aborti është çështje personale apo çështje publike.

Eutanazia

Eutanazia është temë e cila në vazhdimësi gjatë historisë ka nxitur diskutime kontraverse. Çështjet mbi vdekjen ecin paralelisht me çështjet mbi jetën. Vdekja është fakt jetësor, dhe nuk paraqet asgjë më shumë se sa fundi i jetës. Medicina bashkëkohore dhe potencialet e saj (madje edhe) të manipulimit me jetën rezultojnë me pyetjet dhe problemet e reja të *eutanazisë*. Sociologjia dhe shkencat e afërme me sociologjinë vetëm para pak kohe kanë filluar të preokupohen me përcjelljen e veprimtarisë medicinale, e me këtë edhe me problemin e *eutanazisë*.

Kudo në botë, në qarqe edhe akademike e shkencore, por edhe në ato religjioze, zhvillohen diskutime dhe jepen mendime të ndryshme lidhur me atë që quhet “*vrasje nga mëshira*”, që ndryshe njihet edhe si Eutanazia (vdekja e mirë).

Në esencë, kuptimi i eutanazisë është menduar si pozitiv, por vetëm formulimi “*Vrasje nga mëshira*” përmban brenda vetes situatën më kontraverse që e njih fjalori i një gjuhe. Pra edhe vrasje, që është vepër e rëndë penale, e ndaluar, e që është pjesë e fjalorit kriminal, por edhe mëshirë, që është një nga fjalët që e njih fjalori human.¹¹

Pra kemi një përballje mes vrasjes dhe mëshirës. Mbi këto përplasje të skajshme gjendet edhe sot situata për aprovimin ose mos aprovimin e eutanazisë. Zëra pro e kundër ka, normalisht zërat kundër janë me shumicë, por përmbyllja e debatit, nxjerrja e konkludimit të dakorduar është pothuajse e paarritshme.

Shih Black's Laë Dictionary, sixth edition.

Scott f. Gilbert, Developmental Biology 827 (Botimi i 5-të, 1997).

E drejta Penale, Pjesa e Posaçme, Ismet Elezi.

As religjioni nuk e lejon eutanazinë, dhe jo vetëm që nuk e lejon por edhe e ndalon, madje e sheh si mëkat shumë të madh, ndoshta edhe më mëkat se vrasjen klasike (nga jo mëshira). Religjioni e parasheh si mëkat të madh edhe vetëvrasjen. Kurse ligji nuk saksionon vetëvrasjen nga fakti se njeriut që vetëvritet nuk ka si t'i shqiptojë dënimin (por mos të harrojmë se shtytja në vetëvrasje është e ndaluar).

Përkufizime për eutanazinë ka shumë. Në përkthim të drejtpërdrejtë ajo thotë vdekje e mirë apo e lehtë. Eutanazia ose siç njihet në gjuhën shkencore Euthanasia, është një proces pa dhimbje që ndihmon një person me sëmundje terminale, pra vdekjeprurëse, të vdesë para kohe (me dëshirën e tij).¹² Pra ta ndihmosh njeriun të vdesë. Përkufizime të tilla të termit të eutanazisë gjenden edhe në shumë enciklopedi e fjalorë të ndryshëm. Derisa kuptimin burimor apo zanafillën e saj eutanazia paraqiste vetëm lutjen dhe dëshirën e njeriut për vdekje të mirë dhe të pa mundimshme (në popull ne të gjithëve na ka rënë të dëgjojnë edhe lutje të njerëzve për të dashurit e tyre që lëngojnë nga ndonjë sëmundje e pashpresë, të luten të kthehen apo të gjejnë një rrugë). Pra, në një farë forme kjo është edhe eutanazia në gjenezën e saj, që nënkupton vetëm lutjen dhe dëshirën që dikush të vdesë pa dhembje e vuajtje, por kurrsesi nuk nënkuptonte ndërmarrjen e çfarëdo veprimi me të cilin merret jeta e njeriut, i cili vuan i pashpresë për jetë.¹³

Ashtu si krejt bota, edhe vendi ynë ka plot raste të rënda të sëmundjeve të caktuara, madje edhe për vite të tëra, që të shtyjnë të mendosh për eutanazinë. Personalisht në Qendrën Klinike Universitare Nënë Tereza, kur kam shkuar të vizitoj një të afërm, e kam parë një fëmijë që kishte rënë në koma në moshën gjashtë vjeçare pas një aksidenti, por që kishte tetë vite që nuk po zgjohej. Tani ai ishte afër moshës katërbëdhjetë vjeçare. E pranoj se kam përjetuar, ndoshta, momentet më të vështira në jetë, por përsëri nuk jam hamendur, çka do të thotë se, edhe si profesioniste, edhe si njeri, unë i them një Jo të madhe Eutanazisë. Ndoshta maksimumi do të ishte aprovimi i asaj eutanazisë burimore, lutje zotit për rikthim në jetë dhe vendim, asnjë veprim tjetër. Duhet pritur vdekja të vijë natyrshëm. Asnjë lloj vrasje nuk është e lejuar, e as ajo nga mëshira. I vetmi që ndihmon në këtë rast është Zoti, dhe ne na mbetet vetëm të besojmë e jo të vendosim për fatin e personit tjetër.

Mbi *eutanazinë* dhe problemet tjera bashkëkohore të civilizimit bashkëkohor duhet diskutuar shkencërisht e intelektualisht dhe nuk duhet heshtur para problemeve të këtylla.

Në bazë të nenit 2 është ngritur pyetja nëse, në rrethana të caktuara, individët mund të shkelin ndalimin e heqjes së jetës, në mënyrë të veçantë në rastin e një vetëvrasjeje të ndihmuar¹⁴, eutanazisë dhe heqjes së trajtimit mjekësor. Pasojat juridike të këtij veprimi, e drejta ligjore dhe morale për të kërkuar mbështetje nga persona të tjerë për kryerjen e një veprimi të tillë, dhe përgjegjësia e tyre sipas legjislacionit penal.

Për ta konkluduar, pasi kam bërë studimin kam vërejtur që në Shqipëri, konceptet teorike ekzistojnë por ka një boshllëk ligjor të madh në lidhje me eutanazinë, pasi duke mos dalë me një dispozitë konkrete për Eutanazinë, lë shteg për abuzime lidhur me cilësimin ligjor të veprës duke u shkelur të pandehurve të drejtat e tyre procedurale dhe materiale. Mund të mendohet se mungesa e legjislacionit për këtë të fundit sjell si pasojë mohimin në mënyrë të heshtur të së drejtës së gjithsekujt për të vdekur në dinjitet. Eutanazia implikon individin dhe shoqërinë; është çështje përgjegjësie shtetërore dhe vetjake; ndërlikon filozofinë për jetën, teologjinë, etikën, mjekësinë, jurisprudencën që te mos trajtohet me hipokrizi a mjete dhe praktika ilegale që shkelin dinjitetin njerëzor edhe në fund të jetës, por te mbahet një qëndrim i caktuar kundrejt saj nëpërmjet parashikimit të dispozitave ligjore në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Penal dhe ligje të tjera.

Dënimi me vdekje

Dënimi me vdekje ka qenë një shembull i skajshëm torture, një formë ndëshkimi që dhunonte të drejtat e njeriut. Ai përbënte një mënyrë të paligjshme dënimi të cilën e përdorte vetë shteti. Të drejtat e njeriut zbatohen ndaj të gjithëve, përfshirë edhe ata të cilët kryejnë krime mizore. Të drejtat e njeriut janë të patjetërsueshme. Ato nuk jepen për sjellje të mirë dhe nuk mund të hiqen edhe nëse një person ka kryer krime tronditëse dhe brutale.¹⁵

Mesazhi i një shoqërie që beson në të drejtat e njeriut është që këto të drejta nuk duhet të shkelen "kurrë". Ato zbatohen ndaj më të keqit prej nesh ashtu si dhe ndaj më të mirit prej nesh, kjo është pse ato na mbrojnë ne të gjithëve. Dënimi me vdekje shkel të drejtat themelore të njeriut. Dënimi me vdekje është një shkelje e hapur e së drejtës për jetën të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe e së drejtës për të mos iu nënshtuar trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshtërues.¹⁶

Heqja e dënimit me vdekje është një pjesë e paketës së vlerave me titull të drejtat e njeriut, demokracia dhe shteti i së drejtës. Pasojat e dënimit me vdekje jehojnë përtej vrasjes së një kriminelit të veçantë. Kur shteti merr një jetë, ai lëshon një sinjal se ka situata në të cilat vrasja është e pranueshme, kur vrasja autorizohet ligjërisht.

Rezoluta 613 e vitit 1976 e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës "Për të drejtat e pacientit në fazën e fundit të sëmundjes dhe që është duke vdekur".

Në Hollandë, eutanazia dhe dhënia ndihmë në vetvrasje, cilësohen si vrasje e kryer në kushtet e nevojës ekstreme duke qenë se nuk ka mënyrë tjetër për lehtësimin e vuajtjeve; konsideruar gjëndjen shëndetësore dhe arritjet shkencore, vendimi i mjekut është marrë me kujdes duke bërë një vlerësim të plotë; të afërmit dhe pacienti në mënyrë të përsëritur kanë dhënë pëlqimin.

Kjo nënkupton ofrimin e asistencës, udhëzimeve, informacionit, mjeteve që dikush të kryejë vrasje.

Peter HODGINSON dhe Andreë RUTHERFORD, Capital Punishment Global Issues and Prospects, Eaterside Press, Volume II, 1996;

Arthur KOESTLER, Reflects on hanging, Neë York, Macmillan, 1957.

¹⁶ Immanuel KANT, The Metaphysics of Morals, trans, E. Hastie, Edinbrught, 1887; e publikuar origjinal më 1779

Në Shqipëri më 1951 u miratua Kodi Penal ku dënimi me vdekje parashikohej në 31 nene, sidomos për krime kundër shtetit, kundër pasurisë, kundër jetës, etj.¹⁷ Kjo tregonte për ashpërsinë e sanksioneve penale në legjislacionin penal të shtetit totalitar.

Ky kod veprimi për rreth 25 vjet dhe në bazë të tij u dënuan me vdekje shumë njerëz, ndërmjet të cilëve edhe të pafajshëm. Për të plotësuar më mirë kërkesat e shtetit totalitar me 1 tetor 1977 hyri në fuqi kodi i ri, i politizuar dhe dënimi me vdekje u bë edhe më i zakonshëm. Në bazë të këtij kodi u dënuan me vdekje në proceset gjyqësore të viteve 80-të mjaft persona të akuzuar për krime kundër shtetit.¹⁸

Në vitet ‘90-të, me ardhjen e demokracisë reformat në drejtësi diktuan nevojën e një Kodi Penal të ri që ti përgjigjej kërkesave të demokracisë pluraliste. Një vend të rëndësishëm zuri KEDNJ në legjislacionin e brendshëm shqiptar, ku në të cilën përcaktohen qartë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe si asnjëherë tjetër u përcaktuan dhe në Kushtetutën e Shqipërisë. Për këtë mjafton t’u referohemi disa neneve të Kushtetutës.

Në nenin 5, Kushtetuta përcakton se “*Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të*”¹⁹. Ndërsa, në nenin 116, paragrafi 1, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara renditen pas Kushtetutës, në germën “b”, si akte normative, që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.²⁰

Ndërsa në nenin 17, ku flitet për kufizimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë, përcaktohet qartë se “*këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ*”.²¹

Të flasësh për të drejtën e jetës sipas KEDNJ, është sa e lehtë, aq edhe e vështirë. Është e lehtë, sepse tashmë për të gjithë njerëzit, që banojnë ose jo në territoret, mbi të cilët i shtrin efektet kjo Konventë, është më se e qartë se ç’është jeta dhe si mbrohet ajo. Njëkohësisht, është e vështirë, sepse është e nevojshme që të trajtohen këtu të gjitha aspektet e jetës nga këndvështrimi i kësaj Konvente, i cili, përveçse është, padyshim, juridiko-profesional, përfshin edhe përmbledhjen e një mendimi juridik ndërkombëtar, të paktën mbarë europian.²²

Të drejtat e njeriut zbatohen ndaj të gjithëve, përfshirë ata të cilët kryejnë krime mizore. Parimi thelbësor në bazë të të drejtave të njeriut është që ato janë të patjetërsueshme. Ato nuk jepen për sjellje të mirë dhe nuk mund të hiqen edhe nëse një person ka kryer krime tronditëse dhe veprime brutale. Mesazhi i një shoqërie që beson në të drejtat e njeriut është që këto të drejta nuk duhet të shkelen ‘kurrë’.

Ato zbatohen ndaj më të keqit prej nesh ashtu si dhe ndaj më të mirit prej nesh, kjo është pse ato na mbrojnë ne të gjithëve. Dënimi me vdekje shkel të drejtat themelore të njeriut. Si traktate europiane ashtu edhe ndërkombëtare parashikojnë heqjen e dënimit me vdekje në kohë paqeje dhe madje në kohë lufte.

Protokolli Nr. 6 I KEDNJ i trupëzon qartë standardet europiane, duke parashikuar heqjen e dënimit me vdekje në kohe paqeje.²³

Kushtetuta parashikon heqjen e plotë të dënimit me vdekje. Dënimi me vdekje është një shkelje e hapur e së drejtës për jetën të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe e së drejtës për të mos iu nënshtuar trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshtëruës. Një politikë penale humane dhe morale bën dallim ndërmjet kriminelit dhe kriminit dhe kjo është e vetmja politikë me vlerë për një shoqëri demokratike.

Dënimi me vdekje, ashtu siç zbatohet për shembull në SHBA, është mbeturinë e një shenjë barbarizmi dhe kryesisht kënaq instinktet gjakatare të turmës. Tek e fundit, njerëzit që kryejnë krime aq të rënda sa të meritojnë atë lloj dënimi, nuk mendojnë shumë për pasojat e veprimeve të tyre, në momentet kur e kryejnë ose e përgatitin krimin.

Konkluzione

E drejta për të jetuar është e drejta e parë themelore e njeriut, një atribut fundamental i qenies njerëzore gëzimi i së cilës, përbën kusht për gëzimin e të gjitha të drejtave të tjera. Ajo klasifikohet në grupin e të drejtave, që lidhen ngushtë me njeriun si qenie natyrore, me dinjitetin dhe qenien e tij. E drejta e jetës është vendosur në krye të katalogut të të drejtave, e pasqyruar kjo edhe në një sërë dokumentash që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me të drejtat e njeriut.

Në Shqipëri ka akoma shumë për t’u bërë jo vetëm për përjasjen e legjislacionit me parimet e pranuar ndërkombëtare në këtë fushë, por njëkohësisht për zbatimin në praktikë të këtyre të drejtave. E drejta e jetës është një e drejtë negative dhe pozitive, e cila kërkon mosndërhyrjen e shtetit në gëzimin e saj, por njëkohësisht marrjen e një sërë masash pozitive nga shteti, me qëllim mbrojtjen dhe gëzimin efektiv. Neni 2 i Konventës mbron vetëm qeniet njerëzore që ekzistojnë, duke e lënë në diskrecion të shteteve mbrojtjen e fetusit dhe të drejtën e abortit. Probleme këto, që së bashku me eutanazinë, klonimin apo vdekjen klinike janë ende objekt i diskutimeve të mëdha, që ende nuk ka përcaktime unike dhe përfundimtarë për ta. Ky nen mbron jo vetëm jetën e individit nga veprimet ose mosveprimet e personave të tretë, por edhe nga vetvetja.

Neni 31 I Kodit Penal 1951

Idem

Neni 5 I Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë

Neni 116, paragrafi 15 I Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë

Neni 17 I Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Protokolli nr.13

Neni 6 I Konventes Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

Mund të themi se problemi i abortit në kohën moderne është alarmant. Me të gjitha trysnitë që janë bërë e bëhen që abortin ta shpallin si një çështje private, ndaj edhe e drejta e lirisë në jetën private, çështje individuale, tregon se aborti është një çështje e etikës sociale dhe politike. E drejta njerëzore për jetë nuk mund të privatizohet. Secili është i obligueshëm të jetë aktiv në mbrojtjen e jetës, të tregojë solidaritetin.

E drejta për jetën njihet si e drejtë themelore për njeriun, e para në çdo sistem shoqëror. Ajo që ka filluar të diskutohet, është e drejta (nëse mund të quhet) për të zgjedhur vdekjen. Eutanazia, ose “vdekja e mire” siç përkthehet nga greqishtja e lashtë, ka filluar të qarkullojë si ide edhe në ajrin publik shqiptar. Por a është gati Shqipëria të trajtojë diçka të tillë? Jemi gati ne, apo të afërmit tanë, të marrin vullnetarisht vendimin për largimin nga kjo jetë?

Eutanazia është një problem botëror, kështu që nuk mund të përjashtohet as vendi ynë nga kjo çështje. Mjedisi shqiptar duket më konservator lidhur me dilema të tilla si “vdekja e planifikuar”. Për ta konkluduar, pasi kam bërë studimin kam vërejtur që legjislacioni shqiptar ka mangësi të theksuara, pasi duke mos dalë me një dispozitë konkrete për Eutanazinë, lë shteg për abuzime lidhur me cilësimin ligjor të veprës duke u shkelur të pandehurve të drejtat e tyre procedurale dhe materiale. Unë mendoj që nëse Shqipëria vendos që të ketë përparësi e drejta e jetës mbi të drejtën e zgjedhjes së individit, të dalë me një dispozitë konkrete për Eutanazinë duke parashikuar një sanksion të rëndë, për shkak të vetë rrethanave në të cilat kryhet vepra. Më mire se kaq do të ishte të merrej shembulli nga disa vende shumë të zhvilluara dhe demokratike siç janë: Gjermania, Belgjika, Holanda etj, të cilat e kanë depenalizuar këtë veprë.

Dënimi me vdekje është dënimi më i rëndë që mund t'i shqiptohet një njeriu. Ai mundësohet nga ligjet të cilat, edhe pse paradoksalisht e ndalojnë vrasjen, në të njëjtën kohë janë makinë e kryerjeve të kësaj veprë e cila bie në kundërshtim të plotë me lirinë dhe të drejtën e jetës që njëkohësisht ofrohet nga ligji.

Cesare Beccaria thotë: *Dënimi me vdekje nuk mund të jetë i dobishëm për shkak të shembullit të barabaritetit që u jep njerëzve... duket absurde për mua që ligjet... të cilat duhet të dënojnë vrasjen, janë ata të cilët e kryejnë atë vetë.* Andaj, duke u nisur nga ajo që u shtrua më sipër në këtë hulumtim, natyrshëm vjen edhe pyetja: *Pse duhet të vrasim njerëz për të treguar se vrasja e njerëzve është e gabuar?*

Bibliografia

- Keown, J (2001): Eutanazia, Etika dhe Politikat Publike. Një argument kundër Legalizimit. Cambridge University Press.
Anastasi.A, Omari.L., 2010. E drejta Kushtetuese ABC, Tirane.
Elezi, I. 2009, E Drejta Penale, pjesa e posacme, ERIK. Tirane.
Mbrojtja Ndërkombëtare e Të Drejtave Të njeriut Tiranë 2000.
Hodginson P dhe Rutherford A, 1996, Capital Punishment Global Issues and Prospects, Eatterside Press, Volume II.
Koestler A, 1957 Reflects on hanging, New York, Macmillan.
S. Aksoy. Përkthyer nga anglishtja nga Avni Lecaj në revistën Vepra.
Scott f. Gilbert,, 1997. Developmental Biology (Botimi i 5-të).
Zaganjori Xh, 2011. Leksionet për Shkollën e Magjistraturës.

Dokumente

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e OKB.

Kodi Penal i Shqipërisë.

Konventa Europiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e Këshilli i Europës.

Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Protokolli.

Kushtetutes se Republikës së Shqipërisë.

Rezoluta 613 e vitit 1976 e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës “*Për të drejtat e pacientit në fazën e fundit të sëmundjes dhe që është duke vdekur*”.

ROLI NDËRMJETËSIMIT NË ZGJIDHJEN MOSMARRËVESHJEVE NË KOMBËTARE NË KUADËR TË OKB DHE BE

JONIDA MEHMETAJ

Lektore pranë Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Fakulteti i Shkencave Humane, Drejtësi. Doktorante pranë UET. Dega: E Drejtë Ndërkombëtare Publike. E-mail: mehmetajjonida@yahoo.com

ABSTRAKT

Mosmarrëveshjet ndërkombëtare janë fenomene të pashmangshme në rendin ndërkombëtar, rregullimi i tyre me mjete paqësore përbën një nga parimet bazë të së drejtës ndërkombëtare. Studimi analizon konceptin e ndërmjetësisimit, kuadrin ligjor, rolin, efektivitetin dhe mangësitë që shfaq ky mjet në zgjidhjen e një mosmarrëveshje ndërkombëtare. Përveç natyrës së tij dhe elementëve pozitivë, ndërmjetësimi përballet edhe me vështirësi të shumta, në raste të caktuara ai nuk mund të aplikohet dhe mund të dështojë. Përdorimi i një strategjie, ndërmjetësve të aftë, organizimi dhe marrja e informacionit paraprak, janë elementë shumë të rëndësishme për një ndërmjetësim të efektshëm. Ndërmjetësimi si proces ka parasysh zhvillimin e komunikimit ndërmjet palëve, ndryshimin e sjelljeve të aktorëve dhe perceptimin me objektivitet të çështjes në të cilën ata vet janë implikuar. Krahas instrumentit të ndërmjetësisimit në kuadrin e Kombeve të Bashkuara, punimi shqyrton të analizojë rolin e Bashkimit Europian si aktor në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare. Bashkimi Europian mbështetet në parime ndërkombëtare për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve, parime që mishërohen në nenin 33 të Kartës së OKB-së. OKB është ndërmjetësja më e madhe në botë, zgjidhja paqësore e mosmarrëveshjeve është një nga qëllimet kryesore objektive dhe institucionale të saj. Përpjekjet e BE për të qenë e suksesshme në përdorimin e kësaj procedure mbeten një sfidë, pavarësisht përpjekjeve dhe përkushtimit të saj. Kjo sfidë lidhet me afirmimin e saj si një aktor i rëndësishëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare.

Fjalë kyç: *ndërmjetësim, mosmarrëveshje ndërkombëtare, Bashkimi Europian, Organizata e Kombeve të Bashkuara, ndërmjetës.*

Hyrje

Ndërmjetësimi është një nga mjetet paqësore, të metodave politiko-diplomatike, e cila ka në thelb të saj ndërhyrjen aktive, për reduktimin dhe zbutjen e tensioneve ndërmjet aktorëve palë në mosmarrëveshje. Aplikimi i kësaj metode sendërton një atmosferë paqësore në bashkëjetesën e kombeve, duke sjellë efekte pozitive, më të drejtpërdrejta në zgjidhjen e çështjes, duke dëshmuar kulturë dhe modernizim në radhët e kombeve të konsoliduara. Ndërmjetësimi është një nga metodat e cila ka rezultuar më efektive, kjo metodë është përdorur përveç mosmarrëveshjeve në fazat e para të tyre edhe për konfliktet ndërkombëtare. Mosmarrëveshjet dhe konfliktet janë të llojeve të ndryshme, ka mosmarrëveshje që lidhen me sovranitetin, vetëvendosjen dhe mosmarrëveshje territoriale.¹ Kjo metodë ka shërbyer si një mekanizëm efikas po të kemi parasysh rolin që ajo ka luajtur në dhënien fund të luftërave civile në Bosnjë-Hercegovinë, Sudan, Burundi, konflikteve të zgjatura dhe të dhunshme si në Irlandën e Veriut, në nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet Indisë dhe Pakistanit, të Haitit, Koresë së Veriut etj. BE gjithashtu ka ndërmjetësuar dhe luajtur rol të rëndësishëm në një sërë çështjesh si konflikti i Qipros, Gjeorgjisë, Kosovës, Kurdëve të Turqisë, Rusisë, Ukrainës etj. Subjektet e së drejtës ndërkombëtare përplasen në mënyrë të vazhdueshme në përditshmërinë e tyre me njëri tjetrin dhe nevoja e zgjidhjes së këtyre mosmarrëveshjeve me metoda paqësore, si ndërmjetësimi, është e domosdoshme. Por pavarësisht efikasitetit që ndërmjetësimi si procedurë ka evidentuar, sfidat me të cilat ai përballet janë të shumta, ka raste specifike në të cilat ky mekanizëm has në vështirësi dhe është i pa aplikueshëm.

Koncepti i ndërmjetësimit dhe funksionet

Ndërmjetësimi është një proces, një mekanizëm, një instrument për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ose konflikteve ndërkombëtare. Ndërmjetësimi në thelb, në esencë të tij ka referimin si i “tretë”², një subjekt i tretë i cili nuk implikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në mosmarrëveshje. Që nuk ka lidhje më asnjëherë nga palët dhe perceptohet si një i jashtëm, një subjekt i tretë asnjëherë, i paanshëm dhe objektiv. Ndërmjetësimi si një veprimtari jashtëgjyqësor, pjesë e metodave politiko-diplomatike dhe jo gjyqësore si arbitrazhi, synon të propozojë një zgjidhje që nuk bie në kundërshtim me ligjin. Pala e tretë thjesht mund të inkurajojë shtetet në mosmarrëveshje të rifillojnë negociatat, ose t’u sigurojë atyre një element tjetër shtesë të komunikimit.³

Ndërmjetësuesi e vendos theksin në mënjanimin e komunikimit të ashpër dhe presioneve ndërmjet palëve, duke sqaruar çështjet e paqarta dhe duke bërë sugjerime për zgjidhje alternative. Pa një nivel të lartë të gatishmërisë ndërmjet palëve ndër gjyqësore, motivimit dhe angazhimit të tyre në menaxhimin e mosmarrëveshjes, nuk ka gjasa që të arrihet një rezultat i suksesshëm i ndërmjetësimit.⁴ Roli i ndërmjetësuesit konsiston në zgjidhjen e pretendimeve të kundërta dhe në zbutjen e pakënaqësive që mund të kenë lindur mes shteteve që kanë mosmarrëveshje.⁵ Ndërmjetësuesi është një pjesëmarrës aktiv, i autorizuar, i prirur, për të çuar përpara propozime të freskëta dhe për të bërë interpretime të duhura, si dhe për të transmetuar propozimet e secilës palë për tjetrën.⁶

Funksionet e ndërmjetësuesit ose ndërmjetësuesve është të ndihmojnë palët në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në mënyrë më të thjeshtë dhe më të drejtpërdrejtë, duke shmangur formalitetet dhe duke kërkuar një zgjidhje të pranueshme. Për nga natyra, ndërmjetësimi është një procedurë private, konfidenciale, fleksibël dhe informale. Puna e një ndërmjetësuesi është të identifikojë shqetësimet që secila palë mbart në vetvete dhe nuk dëshiron t’i zbulojë në mënyrë të hapur.⁷ Asnjë raport nuk do të bëhet dhe hartohet nga ndërmjetësimi pa pëlqimin e palëve, dhe ky raport do të jenë tërësisht konfidencial.⁸ Ndërmjetësimi mbi bazën e informacionit që ka grumbulluar përpikëqet t’i përafrojë dhe bindë palët për zgjidhjen e problemit të përbashkët pa e nxjerrë informacionin për të cilin ajo është në dijeni.

Ndërmjetësimi aktiv i cili ndërhyt energjikisht, sjell një ndërmjetësim i cili prodhon efikasitet, ndërsa ndërmjetësimi i mbyllur, i rezervuar gjeneron prirje të ulëta për përfundimet të suksesshme. Ndërmjetësimi luan rol të rëndësishëm edhe në fazën paraprake, në përpjekje për të sjellë palët në bisedime, mund të ndodhë që të qëndrojnë deri në këtë fazë, që procesi i tij të mbyllet deri këtu dhe mos paraqesë ndonjë zgjidhje konkrete. Por thjesht të ndihmojë për fillimin e bisedimeve dhe të nxisë palët për arritjen e një marrëveshjeje të suksesshme midis palëve. Disa ndërmjetësues mund të kufizojnë veten e tyre vetëm në dhënien e inkurajimit dhe dhënies së këshillave për rifillimin e negociatave të drejtpërdrejta. Ndërsa të tjerë guxojnë edhe më shumë avancojnë me propozime konkrete dhe madje ushtrojnë presion për kompromis,⁹ ofrojnë shpjegime shkencore dhe teknike në komunikim.

United Nation General Assembly, Report of the Secretary-General, Strengthening the role of mediation in the peaceful settlement of disputes, conflict prevention and resolution, 25 June 2012, fq 4.

Shaw, M., International Law, London Cambridge, 2003, fq. 921; United Nations, Handbook on the Peaceful Settlement of Disputes between States, New York 1992, paragrafi 123, “ndërmjetësimi është një instrument i mjeteve paqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, ku një palë e tretë ndërhyt në pajtojë pretendimet e ngritura nga palët si dhe të çojë përpara propozimet e veta të cilat synojnë një zgjidhje reciprokisht të pranueshme nga të dyja palët”.

J. G. Merrills, International dispute settlement, Cambridge University Press, New York 2005. Fq 31.

Jacob Bercovitch & Su-Mi Lee, Mediating international conflicts: examining the effectiveness of directive strategies. The international of peace study, 2003, Vol. 8, Nr. 1.

Konventa për Zgjidhjen Paqësore të Mosmarrëveshjeve Ndërkombëtare, e vitit 1907, neni 4.

J. G. Merrills, International dispute settlement, Cambridge University Press, New York 2005. Fq 31.

⁷ Ho-Won Jeong, Conflict Management and Resolution an introduction. Routledge, London and USA 2010, fq.174.

American Treaty on Pacific Settlement (Pact of Bogota), neni 12.

⁹ Ho-Won Jeong, Conflict Management and Resolution an introduction. Routledge, London, 2010, fq.178.

Në mënyrë që të sigurohet pa ndërprerje, dialog konstruktiv mes palëve ndër gjyquese, është e rëndësishme të përcaktohen se si do të zhvillohen diskutimet, si do të mbledhen informacione të vlefshme dhe si do të hartohet axhenda. Këto janë detaje të rëndësishme për t'u përgatitur nga një ndërmjetës. Mbledhja e këtyre informacioneve përcakton edhe rolin e procesit të ndërmjetësimit sepse shpesh ndodh që ndërmjetësimi është veçse një instrument ndihmës për zhvillimin e negociatave.¹⁰ Insistimi për përjashtimin apo përfshirjen e agjendave të caktuara për diskutim nga palët mund të pengojë diskutim substancial. Sepse mund të ndodhë devijimi i diskutimit mbi çështje të rëndësishme dhe të orientohen në favor të njëres palë. Ndodh që ndërmjetësuesit dështojnë për të bërë kompromise për shkak të mungesës së informacionit, dhe mos organizimit të axhendës, për të parashikuar të gjitha pyetjet që mund të bëjnë palët në mosmarrëveshje.

Ndërmjetësit dhe pëlqimi për ndërmjetësim

Ndërmjetësimi realizohet nga organizatat, si OKB dhe BE, individët dhe shtetet. Ndërmjetësimi realizohet brenda kornizave normative dhe ligjore, të cilat mund të kenë implikime të ndryshme për ndërmjetësues të ndryshme. Kështu, ndërmjetësuesit e Kombeve të Bashkuara duhet të punojnë në kuadrin e Kartës së Kombeve të Bashkuara, rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit, Asamblesë së Përgjithshme dhe rregulloreve të Organizatës.¹¹ BE punon në përputhje me direktivat, vendimeve e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, si dhe në kuadrin e Kartës së OKB. Përveç OKB dhe organizatave rajonale si BE, ka dhe organizata joqeveritare të cilat në situata të caktuara mund të veprojnë si ndërmjetës. Për shembull, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq ka shërbyer si ndërmjetës në çështje të cilat kërkonin vendosjen e paqes dhe sigurisë. Kjo organizatë joqeveritare ndryshe nga OKB shmang përfshirjen në mosmarrëveshje me karakter politik, por ndërhyr rregullisht në konflikte të armatosura dhe trajtimin e çështjeve humanitare, siç është trajtimi i të burgosurve.¹²

Ndërmjetësimi mund të realizohet gjithashtu nga shtetet dhe nga individët, shtetet si subjektet kryesore të së drejtës ndërkombëtare, luajnë një rol shumë të rëndësishëm. Përcaktimi i shteteve dhe individëve si ndërmjetësues është parashikuar në shumë instrumente ndërkombëtare, më konkretisht tek Pakti Bogota është theksuar që procedura e ndërmjetësimit "konsiston në eliminimin e kundërshtimeve nga një ose më shumë qeveri amerikane, jo palë e mosmarrëveshjes, dhe nga një ose më shumë qytetarë të shquar të ndonjë shteti amerikan që nuk është palë në mosmarrëveshje".¹³ Duke theksuar që ndërmjetës janë shtetet, në rastin konkret shtetet amerikane dhe individët duke përfshirë ata qytetarë me një status të veçantë në shoqëri, që karakterizohen nga integriteti personal dhe vlera qytetare të rëndësishme si presidentë, papë etj.

Një element tjetër që identifikon karakterin e ndërmjetësimit, dhe që është pjesë e nenit që cituam më sipër është që ndërmjetësi nuk duhet të jetë palë e mosmarrëveshjes. Madje ndërmjetësimi konsiderohet edhe si një e drejtë e shteteve. Ndërmjetësimi është një e drejtë që e ka çdo shtet subjekt i së drejtës ndërkombëtare me kushtin e vetëm që të mos jetë palë në konflikt. Gjithashtu dhe shtetet palë në konflikt nuk duhet ta cilësojnë si një akt armik të drejtën e shteteve për të ndërmjetësuar dhe ndihmuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Kjo theksohet edhe në Konventën e Hagës të 1907, ku sipas së cilës "...shtetet që nuk janë pjesë e konfliktit kanë të drejtë të ofrojnë ndihmën e tyre apo të ndërmjetësojnë edhe gjatë gjendjes së luftës. Ushtrimi i kësaj të drejte nuk mund të konsiderohet nga asnjëra prej palëve në mosmarrëveshje, si një akt armiqësor."¹⁴

Ndërmjetësi është i miratuar,¹⁵ i zgjedhur me vullnetin e lirë të të dyja palëve në mosmarrëveshje, pra ndërmjetësimi nuk është një proces i detyruar.¹⁶ Rëndësia e zgjidhjes me marrëveshje dhe konsensus të përbashkët është shumë e rëndësishme, ky tipar përbën edhe një dallim kryesor të këtij instrumenti për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë paqësore. Pakti Bogota kur parashikon procedurën e ndërmjetësimit në nenin 11 të tij, thekson se "...ndërmjetësuesi ose ndërmjetësuesit do të zgjidhen me marrëveshje të përbashkët midis palëve." Ndërmjetësuesi në këtë rast ka vetëm karakter këshillimor dhe asnjëherë nuk ka fuqi detyruese,¹⁷ gjithashtu duhet theksuar se janë përjashtuar në të gjitha rastet ndërhyrjet e palës së tretë që mbështeten në forcën fizike apo tek autoriteti i ligjeve.¹⁸ Karakteri këshillimor i tij e dallon këtë instrument të mjetëve paqësore nga mjetet e tjera paqësore të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të tilla si, mjetet gjyqësore të, arbitrazhi dhe Gjykatat Ndërkombëtare.

Dominique Altheritiere, Settlement of Public International Disputes on Shared Resources: Elements of a Comparative Study of International Instruments, Natural Resources Journal, 1985, Vol. 25. Fq. 707

United Nation Guidance for Effective Mediation, International law and normative frameworks. Marrë nga <http://peacemaker.un.org>, fq 16.

David P. Forsythe, The International Committee of the Red Cross: a unique humanitarian, International review of Red Cross, Vol. 89. No. 865, March 2007, fq 67

American Treaty on Pacific Settlement, Pact of Bogota, 1948, neni 11.

Convention for the Pacific Settlement of International Disputes, 1899, neni 3.

¹⁵ Martin Dixon, E drejta ndërkombëtare, AIIS, Tiranë 2010, fq 365, "ndërmjetësi është një person gjithnjë i miratuar nga të dyja palët, i cili merr pjesë në bisedime dhe ka për detyrë të propozojë kushtet e një zgjidhjeje dhe të përpiqet të arrijë mirëkuptimin nëpërmjet pikëpamjeve kundërshtarë.

J. G. Merrills, International dispute settlement, Cambridge University Press, New York 2005. Fq 32. "Ndërmjetësimi nuk mund të jetë e detyruar mbi palët në një mosmarrëveshje ndërkombëtare, por ndërmjetësimi mund të ndodhë vetëm nëse ata japin pëlqimin e tyre. Pra, nëse ata e kanë marrë iniciativën dhe kanë emëruar një ndërmjetës, mosgatishmëria e palëve për të marrë parasysh këtë formë të ndihmës mund të përbëjë një pengesë të madhe. Kjo është për shkak se edhe pse propozimet e ndërmjetësve nuk janë të detyrueshme, vetë akti i ndërmjetësimit ka pasoja të cilat mund të jenë të papranueshme për një ose të dyja qeveritë e interesuara."

Konventa për Zgjidhjen Paqësore të Mosmarrëveshjeve Ndërkombëtare, e vitit 1907, neni 6.

¹⁸ . Bercovitch, Jacob, "The Structures and Diversity of Mediation in International Relations." në J. Bercovitch and J. Z. Rubin,

Mediation in International Relations: Multiple Approaches to Conflict Managements. New York: St. Martin's Press, 1992, fq. 6-29.

Pëlqimi për ndërmjetësimin i referohet faktit se të dyja palët në mosmarrëveshje mund të zgjedhin lirisht këtë procedurë, kanë liri veprimi dhe vendimi i saj nuk është detyrues për palët. Ndërmjetësimi nuk është një proces i institucionalizuar (si arbitrazh ose formave të tjera të gjykimit) në përgjithësi, dhe për këtë arsye rregullat formale apo procedurat standarde nuk ekzistojnë.¹⁹ Por pëlqimi për ndërmjetësim mund të jetë edhe i “imponuar”, ka disa arsye të cilat kushtëzojnë shtetet të zgjedhin mekanizmin e ndërmjetësimit për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre. Për shembull, në çështjet në të cilat janë përshkallëzuar aq shumë sa mund të çojnë në një konflikt të armatosur, atëherë arena ndërkombëtare nuk mund të qëndrojë duar kryq dhe të shikojë si degradohet situata dhe kërcënohet siguria. Por në mënyrë të tërthortë “detyron” shtetet të bëhen pjesë e një çështjeje në të cilën ata vet mund ta kontrollojnë dhe ta pranojnë ose jo. Por mospranimi i shtetit të implikuar në konflikt, i shton atij përgjegjësinë në sytë e arenës ndërkombëtare. Shtetet janë të shqetësuara edhe se si perceptohen nga shtete të cilat kanë marrëdhënie të mira, simpati, respekt dhe interesa të drejtpërdrejta.

Nëse ndonjëra nga qeveritë i “qorton” për mënyrën e implementimit të politikave apo strategjive, ato mund të vijnë më pas edhe me tërheqjen e mbështetjes politike apo ekonomike, çka asnjë shtet i përfshirë në një mosmarrëveshje ose në një konflikt nuk e dëshiron. E para sepse cenon drejtpërsëdrejti marrëdhëniet e mira ndërmjet shteteve, dhe e dyta sepse në një situatë konfliktuale lipset nevoja e sa më shumë aleatëve të cilët të japin mbështetje në një konflikt të mundshëm, mbështetje e cila mund të jetë si në këshillim, diplomaci, ekonomi dhe mbështetje ushtarake. Për shembull, në rastin e Ishujve Falkland, si Britani ashtu edhe Argjentina kanë qenë shumë të shqetësuara për të siguruar dhe për të ruajtur simpatinë e aleatëve rajonale.²⁰ Por mbështetja e një shteti aleat kushtëzohet edhe nga natyra e konfliktit, dhe interesave të drejtpërdrejta që kanë shtetet për t’u bërë pjesë apo aleatë të konfliktit. Rolet dhe funksionet e palëve të treta mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në varësi të qasjes dhe natyrës së aktorëve të përfshirë.²¹ Pra në një mbështetje nga aleatët dhe në një zgjidhje të mosmarrëveshjes rëndësi ka natyra e konfliktit por për një zgjidhje efektive të tij së bashku me natyrën e konfliktit shtrihen edhe elementë të tjerë. Për të përcaktuar më mirë këto elementë dhe natyra të cilat janë decizive për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje apo konfliktit i referohemi Bercovitch, sipas të cilit, “në një mosmarrëveshje, natyra e palëve në mosmarrëveshje, natyra e mosmarrëveshjes, natyra e ndërmjetësuesit dhe karakteristikat e procesit të ndërmjetësimit janë komponentë kyçë për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje.”²²

Por duke ndjekur linjën e arsytimit për rolin që luan e drejta ndërkombëtare dhe ndërhyrjet e saj në konflikt, raste praktike kanë treguar se përveç krijimit të aleancave dhe mbështetjes që mund të japin ato, ka edhe presione të drejtpërdrejta. Për shembull në rastin e Serbisë në luftën me Kosovën, apo në luftë me Bosnjën, Serbia ishte nën presion të rëndë ekonomik nga sanksionet ekonomike të vendosura nga OKB-ja dhe BE-ja. Mënyrat e reagimit nga komuniteti ndërkombëtar janë të ndryshme ndërmjet sanksioneve të ndryshme të cilat detyrojnë palët të hyjnë në bisedime dhe të përpiqen të zgjidhin konfliktin. Shpeshherë sugjerohet mjeti i ndërmjetësimit në këto konflikte, si një mjet i përshtatshëm për të afruar palët me njëra tjetrën, për të mos kushtëzuar palët në zgjidhje të menjëhershme jashtë dëshirës së tyre dhe duke i lënë atyre liri veprimi në zgjidhje. Ndërmjetësimi, gjithashtu është i rëndësishëm kur mosmarrëveshja ka përparuar në një fazë në të cilën palët janë të detyruara të rishohin politikat e tyre.

Duke pranuar ndërmjetësimin, një qeveri e pranon se mosmarrëveshja e saj është një çështje legjitime e shqetësimit ndërkombëtar.²³ Arsye tjetër që mund të çojë shtetet në mosmarrëveshje të zgjedhin metodën e ndërmjetësimit është edhe sepse situata është acaruar aq shumë, apo konflikti mund të jetë zgjatur në dekada sa shtetet nuk kanë më fuqi as interes për të vazhduar luftën, sepse ndonjëherë ndodh që humbjet mund të jenë më të mëdha sesa përfitimi. Ndërmjetësuesit në zhvillimin e punës së tyre duhet të jenë të informuar dhe të njohur me ligjin e aplikueshëm ndërkombëtar dhe kornizat normative,²⁴ në mënyrë që të arrijnë të jenë efektiv edhe në situata shumë problematike, edhe kur situata ka degraduar në konflikt apo dhunë të armatosur dhe asnjë mjet paqësor nuk mund të jetë i efektshëm.

Qëllimi i ndërmjetësimit nën këto rrethana mund të jetë arritja e një zgjidhje të përkohshme, një armëpushimi kur lufta ka filluar ose nëse ndërmjetësimi do të rezultojë shumë i suksesshëm të sjellë një zgjidhje të përhershme.²⁵ Mund të ndodhë që ndërmjetësimi jo kurdoherë është i përshtatshëm, nëse flasim për mosmarrëveshje të cilat janë shndërruar në konflikte të ashpra si p.sh, skandali në Afrikën e Jugut në epokën e aparteidit,²⁶ ndërmjetësimi do të ishte një procedurë e pallogaritshme. Ndërmjetësi zgjidhet nga palët jo për shkak të neutralitetit të tij por për shkak të aftësisë së tij për të prodhuar rezultat atraktive.²⁷ Një shembull i situatës ‘pa-kompromis’ është dhënë nga Nigeria e cila kishte refuzuar të pranonte ndërmjetësimin gjatë luftës separatiste në Biafra, duke pretenduar që është një çështje e juridiksionit të brendshëm.

¹⁹ Ho-W on Jeong, *Conflict Management and Resolution an introduction*. Routledge, London and USA 2010, fq.173.

J. G. Merrills, *International dispute settlement*, Cambridge University Press, New York 2005. Fq 32.

²¹ James A. Wall, ‘Mediation: An Analysis, Review, and Proposed Research’, *Journal of Conflict Resolution*, 25/1 (1981), 157–80.

Jacob Bercovitch and Allison Houston, “The Study of International Mediation: Theoretical Issues and Empirical Evidence,” *Resolving International Conflict: The Theory and Practice of Mediation*, Jacob Bercovitch ed., Lynne Rienner Publishers, Inc., (Boulder, CO, 1996), 11-35.

J. G. Merrills, *International dispute settlement*, Cambridge University Press, New York 2005. Fq 32.

United Nation, *International law and normative frameworks*. Marrë nga <http://peacemaker.un.org>, paragrafi 42.

United Nations, *Handbook on the Peaceful Settlement of Disputes Between States*, New York, 1992, fq. 42, paragrafi 128.

J. G. Merrills, *International dispute settlement*, Cambridge University Press, New York 2005. Fq 32.

William Zartman & Saadia Touval. *International mediation: conflict resolution and power politics*. *Journal of social issues* Vlo. 41. No 2, 1985, fq, 27.

Mosmarrëveshjet dhe ndërmjetësimi efektiv

Për sa i përket të drejtën ndërkombëtare aktuale, duhet të theksojmë se mosmarrëveshjet pas gati dy dekada në rënie, kanë filluar të rriten, e evidentuar kjo edhe nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB²⁸. Pavarësisht rritjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet subjekteve të së drejtës ndërkombëtare, strukturat kompetente për ndërhyrje dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nuk qëndrojnë indiferente. Institucionet kanë ngritur qendrat e tyre në zonat potenciale të mosmarrëveshjeve kudo në botë, dhe personel të specializuar, ekspertë, zyrtarë politikë, të sigurisë dhe ndërmjetës që përipiqen të ndërmjetësojnë dhe zgjidhin mosmarrëveshjet.²⁹ Shumë nga konfliktet e dekadës së fundit janë krijuar si rezultat i ndryshimeve antikushtetues në qeveri, zgjedhje të diskutueshme,³⁰ tranzicioneve problematike, tensioneve sociale, etj.

Në kontrast me konfliktet kryesisht ideologjike në vitet 1970 dhe 1980, konfliktet mbi kontrollin e qeverisë, si dhe burimet natyrore dhe ekonomike janë ato lloje të mosmarrëveshjeve të cilat janë prezentë dhe mbizotërojnë në axhendën aktuale. Këto konflikte janë të veshura me polarizim etnik, tensione socio-ekonomike dhe qeverisje e dobët. Si rezultat, përpjekjet për ndërmjetësimin kanë mundur të sigurojnë një armëpushim dhe janë fokusuar në arritjen e plotë të stabilitetit në një gamë të gjerë të çështjeve si ndarja e pushtetit, kushtetutat, drejtësia, të drejtat e njeriut dhe çështjet e sigurisë. Nevoja e mbështetjes tek procedura e ndërmjetësimi është thelbësore në mjedise politike të brishta, dhe në vendet ku mungon vazhdimi i procesit formal të paqes.³¹ Shumë prej këtyre përpjekjeve për ndërmjetësimin janë bërë për mosmarrëveshje me natyrë politike. Përpjekjet për ndërmjetësimin janë përdorur gjithashtu edhe për mosmarrëveshjet apo konfliktet mbi burimet natyrore. Për shembull, Qendra Rajonale e Kombeve të Bashkuara për diplomacinë parandaluese për Azinë Qendrore luan një rol të rëndësishëm ndërmjetësimi në promovimin e ndarjes së përgjegjshme dhe menaxhimin e furnizimit me ujë të rajonit në pesë shtete të Azisë Qendrore.³²

Bercovitch e vendos theksin tek strategji-direktivë, që një ndërmjetësim të jetë efektiv. Sipas tij një ndërmjetës ndikon në përmbytjen dhe thelbin e procesit të bisedimeve, duke siguruar stimuj për palët apo lëshimin e ultimatumave dhe duke i bërë palët të vetëdijshëm për kostot e mos-marrëveshje.³³ Që një proces ndërmjetësimi të jetë i efektshëm është e nevojshme që ai të jetë i strukturuar sipas strategjive, dhe autorë të ndryshëm përfshirë këtu edhe **Bercovitch**, i ndajnë ato në strategjitë “direktivë” dhe strategji “jo-direktivë”. Duke evidentuar se strategjitë «direktivë» janë më efektive se strategjitë jo-direktive. Mbi bazën e kësaj lidhja ndërmjet strategjive direktive dhe rezultateve të suksesshme është shumë e fortë, kryesisht në marrëdhëniet e punës të menaxhimit. Menaxhimit të konflikteve ndërkombëtare është bërë një prioritet në axhendën globale.

Strategjia direktive, përcakton hartimin e një plani, veprimi dhe organizimi, që siç e përcaktuam më lartë, organizimi dhe marrja e informacionit paraprak janë shumë të rëndësishme për një ndërmjetësim të efektshëm. Strategjia e ndërmjetësimit përcakton një plan të hartuar detajisht për mënyrën se si do të zhvillohet procesi i ndërmjetësimit. Autorë të ndryshëm i referohen edhe si qasje apo metodë që ka ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Dallimet në zbatimin e strategjive të ndryshme të ndërmjetësimit mund të atribuohet se si një ndërmjetës zgjedh të trajtojë procesin e ndërmjetësimit, sjelljet strategjike si dhe kontekstin specifik të konfliktit.³⁴ Touval dhe Zartman (1985) identifikojnë tri kategori diskrete të sjelljes në ndërmjetësim, të cilat janë, komunikimi, formulimi, dhe manipulimi. Kjo tipologji na lejon për të analizuar dhe kuptuar se çfarë bëjnë në të vërtetë ndërmjetësimin, kur ata të përfshihen në një konflikt, dhe sa të suksesshëm ata mund të jenë duke analizuar modelet e ndryshme të sjelljes të cilat të çojnë në rezultate të ndryshme.³⁵ Në shumë raste, Kombet e Bashkuara kanë punuar në partneritet të ngushtë me organizatat rajonale, për shkëmbim informacioni dhe ndarjen e punës. Por ndërmjetësimi ka dhe sfidat e veta, ka dhe vështirësi si p.sh në rastin e Libisë ku Këshilli i Sigurimit nuk ishin dakord me Unionin Afrikan mbi një strategji dhe qëndrim të përbashkët.

Bashkimi European dhe zgjidhja e konflikteve ndërkombëtare

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve qëndron në thelb të ekzistencës të BE sepse siç thotë dhe Klaus-Dieter Borchardt “nuk ka motivim më të madh për BE sesa dëshira për paqe”.³⁶ Bashkimi European në një sërë dispozitash rregullon veprimin e jashtëm të BE në funksion të ruajtjes së vlerave themelore të sistemeve demokratike, sigurisë dhe paqes në rajon dhe më gjerë. Në nenin 24 të Traktatit të Bashkimit European, dikur paragrafit 11 i preambulës së Traktatit të Themelimit të Bashkimit

²⁸ Sekretari i përgjithshëm, fq4, cituar nga Lotta Themner and Peter Wallensteen, “Armed Conflicts, 1946-2011”, Journal of Peace Research 49(4) (2012).

General Assembly resolution 66/163 on Strengthening the role of mediation in the peaceful settlement of disputes, conflict prevention and resolution. Fq. 7.

Ibid

Ibid

General Assembly resolution 66/163 on Strengthening the role of mediation in the peaceful settlement of disputes, conflict prevention and resolution, fq.8.

Jacob Bercovitch & Su-Mi Lee, Mediating international conflicts: examining the effectiveness of directive strategies. The international of peace study, 2003, Vol. 8, Nr. 1.

ibid

William Zartman & Saadia Touval. International mediation: conflict resolution and power politics. Journal of social issues Vlo. 41. No 2, 1985, fq. 27-45

³⁶ Klaus-Dieter Borchardt, The ABC of European Union law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2010, fq 21.

European, thekson se, shtetet anëtare veprojnë në bazë të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë për të “forcuar paqen, sigurinë dhe përparimi në Evropë dhe në botë”.³⁷ Pavarësisht dispozitave të Traktatit të Bashkimit European që rregullojnë Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurimit, në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe ekzistencës së një rendi ndërkombëtare të sigurt.

Rëndësi të madhe mbart dhe njohja që i bën Bashkimi parimeve dhe qëllimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Në këtë linjë arsytimi ndërmjetësimi shpjegohet si instrument i rëndësishëm i mjeteve paqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve e theksuar në nenin 33 të Kartës së OKB. Bashkimi European mbështet dhe mbron dispozitat e kësaj Karte dhe aplikon metodën e ndërmjetësimit në rastet në të cilat ky mjet është i përdorshëm dhe rezulton i suksesshëm. Përpyekjet dhe vendosmëria e BE për të luajtur një rol të rëndësishëm apo për të asistuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, përcaktohet shprehimisht në një sërë dispozitash. Sipas nenit 21, pikë 2, të TBE, “Bashkimi përcakton, ndjek politika dhe veprime të përbashkëta, kontribuon dhe punon për një shkallë të lartë bashkëpunimi në të gjitha fushat e marrëdhënieve ndërkombëtare në mënyrë që të ruajë paqen të parandalojë konfliktet dhe të fuqizojë sigurinë ndërkombëtare, në përputhje me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara.”³⁸ Bashkëpunimi me Organizatën e Kombeve të Bashkuara si ndërmjetësja më e madhe në botë, mirëpritet nga Bashkimi duke shprehur se “qëllimi i tij është të nxitë zgjidhjet shumëpalëshe dhe problemet e përbashkëta, në veçanti në kuadër të Kombeve të Bashkuara”.³⁹

Bashkimi ka ndërtuar një sërë strukturash dhe instrumentesh të cilët kanë si qëllim reduktimin e mosmarrëveshjeve jo vetëm brenda BE por dhe jashtë saj. Një vëmendje e veçantë i kushtohet, reduktimit të mosmarrëveshjeve në vendet fqinjë dhe në të gjithë rendin global, duke u fokusuar në Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe sfidat globale. Politika Evropiane e Fqinjësisë në mënyrë eksplicite ka për qëllim të promovojë vlerat e BE-së, si një mjet për të përhapur stabilitetin, siguri dhe prosperitetin.⁴⁰ Zgjidhja e mosmarrëveshjeve si pjesë e vlerave themelore të Bashkimit, janë specifikuar në nenin 2 të Traktatit të Bashkimit European. Mbi bazën e këtyre vlerave të rëndësishme, BE nëpërmjet politikave të saj të fqinjësisë evropiane, aspiron të forcojë kontributin e saj për zgjidhjen e konflikteve rajonale.⁴¹ Në mënyrë që Politika Evropiane e Fqinjësisë të mbetet relevante për partnerët e saj, e qëndrueshme, të shmangë krizat politike, ekonomike dhe të sigurisë, BE-ja, përmes Politikës Evropiane të Fqinjësisë, vepron me diplomaci, për parandalimin e konflikteve dhe me anë të ndërmjetësimit.⁴²

Të gjitha këto vlera themelore janë në fund të fundit të varura nga siguria.⁴³ Bashkimi i udhëhequr nga vlerat që përmenden në nenin 2, promovon paqen në botë nëpërmjet ndërtimit të saj, parandalimit të konfliktit, ndërmjetësimit dhe dialogut. Qëllimi i ruajtjes së paqes, parandalimin e mosmarrëveshjeve, konflikteve të armatosura dhe forcimi i sigurisë ndërkombëtare përbëjnë elementë të rëndësishëm të BE siç është përcaktuar edhe në Traktatin e Lisbonës, më saktësisht në nenin 2 të tij.⁴⁴

Llojet e konflikteve të cilat janë në fokus të trajtimit dhe zgjidhjes nga Bashkimi European janë të shumta. Aktiviteti i saj shtrihet në rajonet fqinjë si Ballkani, Kaukazi dhe Lindja e Mesme, si dhe zonat më larg në Afrikë dhe Azi Qendrore. Këto aktivitete kanë përfshirë dy veprime, veprimet afatshkurtër dhe afatmesme që kanë për qëllim menaxhimin civil dhe ushtarak të krizës, zgjidhjen e konflikteve dhe rehabilitimin, si dhe përpjekjet afatgjata të përshtatura për shtet-ndërtimin, demokratizimin dhe pajtimin shoqëror.⁴⁵

Nathalie Tocci studiuese e zgjidhjes së konflikteve nga Bashkimi European pohon se “duke patur parasysh natyrën e BE si një entitet *sui generis*, e angazhuar në respektimin e të drejtës ndërkombëtare, Bashkimi, në mënyrë tipike, ka prioritet, integritetin territorial të shteteve krahas respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të individit.” BE ka marrë pjesë në zgjidhjen e të gjitha konflikteve rajonale dhe globale të cilat kërcënonin sigurinë dhe paqen. Rol të rëndësishëm BE-ja ka luajtur në luftërat që pllakosën Ballkanin perëndimor pas rrëzimit të regjimeve komuniste, luftën ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ku kërcënohej integriteti territorial. Mbështetja e saj ka qenë e evidente në Plani Anan në Qipro, roli i saj në ndërmjetësimin e Serbisë me Malin e Zi, në marrëveshjen e Ohrit në Maqedoni, në Bosnjë, vendosja e sanksioneve kundër Rusisë në konflikt me Ukrainën. Fokusi i saj ka qenë prezent gjithashtu edhe në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, minoriteteve, dallimeve etnike, fetare. Në rastin e kurdëve të Turqisë për shembull, BE-ja ka mbështetur dhe ka ushtruar presion për përforcimin e të drejtave individuale të njeriut, pjesëmarrjen efektive politike, zgjerimin e të drejtave kulturore dhe të minoriteteve ndaj shtetasve kurdë.⁴⁶

Neni 24 i TBE, paragrafi 2 “Brenda kuadrit të parimeve dhe objektivave të veprimit të tij të jashtëm, Bashkimi realizon, përcakton dhe zbaton një politikë të përbashkët të jashtme dhe të sigurimit, mbështetur në zhvillimin e solidaritetit të ndërsjellë politik mes shteteve anëtare, identifikimin e çështjeve me interes të përgjithshëm dhe arritjen e një shkalle gjithnjë e më të madhe konvergjence të veprimit të Shteteve Anëtare”.

Traktati i Bashkimit European neni 21, pika 2, c.

Traktati i Bashkimit European Neni 21, pika 1.

⁴⁰ Nathalie Tocci, *The EU and Conflict Resolution. Promoting peace in the backyard*, Routledge, USA and Canada 2007, fq 7.

European Neighbourhood Policy Strategy Paper, Brussels, COM(2004) 373. Marrë nga: <http://www.ec.europa.eu>, fq 6.

European Commission. Joint Communication to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and The Committee of the Regions. *Neighbourhood at the Crossroads: Implementation of the European Neighbourhood Policy in 2013*. Brussels, 2014, Fq 17.

⁴³ Klaus-Dieter Borchardt, *The ABC of European Union law*, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2010, fq 24

Traktati i Lisbonës, artikulli 2, sipas të cilit “Qëllimi i Bashkimit është të promovojë, vlerat e saj dhe mirëqenien e popujve të saj.”

⁴⁵ Nathalie Tocci, *Conflict Resolution: Theories and Practice. The EU in Conflict Resolution*, London and New York: Routledge, 2011, fq. 2.

Commission of the EC (2006) Communication from the Commission to the Council and the European Parliament on Strengthening the

European Neighbourhood Policy, Brussels.

Por së bashku me suksesin Bashkimi mbart në vetvete paaftësinë, dobësitë dhe mangësitë që ai ka zotëruar duke mos qenë aktor i rëndësishëm, ose ka qenë aktor por i pafuqishëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konflikteve, rajonale dhe globale. Kjo ka qenë prezente në fillimet e saj dhe në faza të mëvonshme në momente të caktuara. Shtetet anëtare shpeshherë kanë treguar paaftësinë, dhe ngurrimin për të ndarë sovranitet dhe vepruar si pjesë përbërëse e bashkimit, si një i vetëm në çështjet ndërkombëtare. Luftërat e zgjatura në Ballkanin Perëndimor pavarësisht ndërhyrjeve dhe përpjekjeve për zgjidhjen e konflikteve, treguan një dështim⁴⁷ për BE. Ky dështim e shtyu BE të zgjeronte politikën, direktivat dhe rregulloret në drejtim të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë në Traktatin e Lisbonës, veçanërisht në fushat e sigurisë dhe të mbrojtjes, duke kontribuar në stabilizimin e Ballkanit Perëndimor, dhe ndërveprimin në rajone të tjera më të largëta.

Konkluzione

Në bazë të analizës së mësipërme mund të konkludojmë se ndërmjetësimi është një nga procedurat më efikase për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare. Historia ka treguar se aplikimi i kësaj procedure ka rezultuar e suksesshme. Në sajë të përkushtimit nga ana e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe organizatat e tjera rajonale, duke vlerësuar këtu dhe rolin e Bashkimit Europian, kjo procedure ka arritur të zgjidhë një sërë mosmarrëveshjes ndërmjet shteteve. Karakteri i saj paanshëm, këshillues, orientues, informues, konfidencial, si një palë e tretë e jashtme, ju ofron palëve siguri për t'u ulur në bisedime dhe për të shpalosur problemet që kanë ndërmjet tyre.

Procedura e ndërmjetësimit nuk është një procedurë e lehtë për t'u zhvilluar, ajo kërkon kohë, angazhim dhe shumë punë. Marrja e informacionit paraprak, hartimi i një strategjie, analizimi i situatës, gjetjes së zgjidhjeve paraprake janë elementë deciziv që një ndërmjetësim të rezultojë i suksesshëm. Ndërmjetësimi ka mangësitë e veta të cilat kushtëzohen nga mungesa e një plani pune të mirë. Gjithashtu karakteri i saj i brishtë për të mos detyruar palët në zgjidhjen e mosmarrëveshjes bën që ndërmjetësimi të mos jetë i aplikueshëm si procedurë në të gjitha mosmarrëveshjet, duke përfshirë këtu ato më të dhunshmet. Dallimet kulturore, etnike, fetare, politike, ekonomike janë të qarta ndërmjet shteteve dhe në një mosmarrëveshje e cila i ka rrënjët shumë të forta ndonjëherë rezultojnë shumë e vështirë ulja në bisedime apo arritja e një zgjidhje, e gjitha kjo si pasojë e konflikteve të ashpra. Por pavarësisht mangësive dhe dobësive që mbart procedura e ndërmjetësimit, ajo ka rezultuar në shumicën e rasteve e suksesshme krahasuar me mjetet e tjera të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërkombëtare.

BE luan një rol të rëndësishëm, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare është angazhuar të zgjidhë mosmarrëveshjet që kërcënojnë sigurinë, në bashkëpunim me partnerët e saj globalë, rajonale kombëtare dhe lokale. Por mangësitë dhe paaftësia e BE për të mos zgjidhur dot konfliktet ndërkombëtare ka qenë e pranishme, kryesisht në raste ku BE nuk kapacitetin e duhur për të menaxhuar një konflikt.

Bibliografia

- Alheritiere, D. (1985) Settlement of Public International Disputes on Shared Resources: Elements of a Comparative Study of International Instruments, *Natural Resources Journal*. Vol. 25.
- American Treaty on Pacific Settlement (Pact of Bogota).
- Bercovitch, J. & Su-Mi Lee** (2003) Mediating international conflicts: examining the effectiveness of directive strategies. *The international of peace study*. Vol. 8, Nr. 1.
- Bercovitch, J. and Houston, A. (1993) Influence of Mediator Characteristics and Behavior on the Success of Mediation in International Relations. *International Journal of Conflict Management*, Vol. 4, No. 4.
- Bercovitch, J. (1991) International Mediation and Dispute Settlement: Evaluating the Conditions for Successful Mediation. *Negotiation Journal*. Vol. 7, No. 1.
- Brigg, M. (2008) *The New Politics of Conflict Resolution Responding to Difference*, USA: Palgrave Macmillan.
- Burton, J. (1969) *Conflict and Communication*. London: MacMillan.
- Checkel, J. (1999) Norms, Institutions and National Identity in Contemporary Europe, *International Studies Quarterly*. Collier, John, and Lowe, V. (1999) *The Settlement of Disputes in International Law: Institutions and Procedures*. Oxford: Oxford University Press.
- Commission of the EC (2003) *Wider Europe- Neighbourhood: A New Framework for Relations with our Eastern and Southern Neighbours*.
- Convention for the Pacific Settlement of International Disputes 1907 and 1899
- Dixon, M. (2010) *International law*. Tirana: AIIS.
- European Commission. Joint Communication to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and The Committee of the Regions. *Neighbourhood at the Crossroads: Implementation of the European Neighbourhood Policy in 2013*. Brussels, 2014.
- Forsythe, D. (2007) The International Committee of the Red Cross: a unique humanitarian. *International review of Red Cross*. Vol. 89, No. 865.
- General Assembly resolution 66/163 on Strengthening the role of mediation in the peaceful settlement of disputes, conflict prevention and resolution.
- Hill, C. (2001) The EU capacity for conflict prevention *European Foreign Affairs Review*, 6: 3.
- Ian, B. (2009) The Peaceful Settlement of International Disputes. *Chinese Journal of International Law* 8. 2.

⁴⁷ Ibid

- Jeong, H. (2010) *Conflict Management and Resolution an introduction*. London and USA: Routledge.
- Mayer, B. (2004) *Beyond Neutrality Confronting the Crisis in Conflict Resolution*. USA: Jossey-Bass
- Merrill, J. G. (2005) *International dispute settlement*. New York: Cambridge University Press.
- Michael, R. (2012) The Diversity of Contemporary International Dispute Resolution: Functions and Policies. *Journal of International Dispute Settlement* 3.1.
- Pettersson, TH. and Themner, L. (2010) *States in Armed Conflict 2009*. Uppsala University Department of Peace and Conflict Research.
- S. Ratner, (1995) Image and Reality in the United Nations' Peaceful Settlement of Disputes, *European Journal of International Law*. Vol. 6, No. 1.
- Shaw, M. (2003) *International Law*. London: Cambridge University Press.
- Tocci, N. (2004) *Conflict Resolution in the European Neighbourhood: The Role of the EU As a Framework and As an Actor*, EUI Working Paper 29, Florence.
- Tocci, N. (2007) *The EU and Conflict Resolution. Promoting Peace in the Backyard*, London: Routledge.
- The American Treaty on Pacific Settlement (Pact of Bogota) of 1948
- The Charter of the Organization of African Unity and Protocol of the Commission of Mediation, Conciliation and Arbitration of 1964
- The Pact of the League of Arab States 1945
- United Nation General Assembly Resolution 37/10. (1982) Manila Declaration on the Peaceful Settlement of International Disputes.
- United Nation General Assembly, (2012) Report of the Secretary-General, Strengthening the role of mediation in the peaceful settlement of disputes, conflict prevention and resolution.
- United Nation. (2012) *United Nations Guidance for Effective Mediation*.
- United Nations. (1992) *Handbook on the Peaceful Settlement of Disputes Between States*, New York.
- Wallensteen, P. (2002). *Understanding conflict resolution War, Peace and the Global System*, London: SAGE Publications.
- Yarn, D.H. (1999) "Conflict" in *Dictionary of conflict resolution*. San Francisco: Jossey-Bass.
- Zartman, W. & Touval, Z. (1985) International mediation: conflict resolution and power politics. *Journal of social issues* Vol. 41, No. 2.

EKONOMIA E KOSOVËS DHE E SHQIPËRISË GJATË KRIZËS GLOBALE FINANCIARE

PHD. CAND. JETA NUSHI

PhD candidate në Universitetin Europian të Tiranës, Ekonomik, Financë

ABSTRAKT

Krizat financiare kanë qenë fenomen shoqëruar i zhvillimit ekonomik të vendeve të ndryshme. Studimi i krizave financiare është i rëndësishëm pasi ato kanë qenë shkak i rënieve të forta ekonomike, situatë e cila është përsëritur edhe në shekullin XXI. Kriza globale financiare e cila u lind në SHBA kaloi edhe në Evropë duke përfshirë vendet e eurozonës si dhe ato jashtë eurozonës. Andaj qëllimi i këtij punimi është që të analizojmë dy vendet e Evropës Juglindore si Kosovën dhe Shqipërinë ku do të bëjmë analiza dhe krahasime duke treguar se sa janë prekur ekonomit e këtyre dy vendeve nga kriza financiare. Pasi që Kosova si monedhë kombëtare ka euron dhe është pjesë e eurozonës do të analizojmë se sa është reflektuar kjo krizë në ekonominë e Kosovës, ndërsa Shqipëria si monedhë kombëtare ka lekun dhe nuk është pjesë e eurozonës gjithashtu do të analizojmë sa është reflektuar kjo krizë në ekonominë e Shqipërisë. Pyetjet kërkimore të punimit janë: Sa është prekur Kosova dhe Shqipëria nga kriza financiare?, Kosova si pjesë e eurozonës a ka ndikuar që kriza financiare të reflektohet më shumë në krahasim me Shqipërinë që nuk është pjesë e eurozonës? Në cilat sektor financiar është reflektuar kriza në dy vendet? Sa ka qenë niveli ekonomik në kohë krize prej vitit 2008 – 2014? Gjatë kësaj periudhe si kanë qenë nivelet e instrumenteve makroekonomike?. Pjesa e parë e letrës merret kryesisht me me historikun e evolimit të krizës globale financiare dhe përhapjen e saj në eurozonë. Në pjesën e dytë do të tregojmë ndikimin e krizës financiare në Kosovë dhe Shqipëri gjatë vitit 2008 – 2013 duke analizuar sektorët që janë përfshirë në krizë pastaj do të bëjë krahasimin e këtyre dy vende duka analizuar si ka ndikuar kjo krizë në instrumentet makroekonomike si në nivelin e rritjes ekonomike, papunësinë, IHD, dërgimin e remitançave etj. duke përfshirë periudhën 2008 – 2014. Në fund unë do të shpjegoj se për pasojat e krizës globale financiare, çfarë masa u ndërmerorën për të parandaluar këtë krizë.

Fjalë kyç: *Kriza globale financiare, eurozona, euro, leku, tregjet ndërkombëtare*

1. Hyrje

Kriza globale financiare ishte problem serioz, ku kishte të bënte me luhatje drastike të tregjeve financiare në SHBA, Evropë dhe Azi dhe rritja e rrezikut që kriza e borxheve fundosi ekonomitë e shumë vendeve të BE-së siç ishin Greqia, Portugalia, Irlanda dhe Spanja si dhe shumë vende të tjera të Evropës. Edhe ekonomitë e vendeve të Evropës Juglindore në këtë rast Kosova dhe Shqipëria ndjenë krizën financiare sepse ekonomia e këtyre vendeve ndikohet edhe nga vendet të Eurozonës dhe në këtë rast ato këto vende u ndikuan drejtpërsëdrejti nga vendet e eurozonës në kushtet e krizës së borxheve që preku. Për këtë arsye rritja ekonomike e Kosovës dhe e Shqipërisë u ngadalësua dhe kriza u ndje në disa instrumente makroekonomike. Andaj ky punim përmban një analizë të gjendjes ekonomiko-financiare të Kosovës dhe Shqipërisë gjatë kohës së krizës, ku fillimisht përshkruhen zhvillimet e krizës në SHBA dhe Evropë dhe impaktet e tyre në ekonomitë e Kosovës dhe Shqipërisë, zhvillimet e politikës monetare, mbikëqyrja dhe veprimtaritë tjera të Bankave Qendrore të këtyre dy vendeve.

2. Qëllimi dhe metodologjia e punimit

Qëllimi i punimit është që të analizojmë dy vendet e Evropës Juglindore si Kosovën dhe Shqipërinë duke treguar se sa janë prekur ekonomitë e këtyre dy vendeve nga kriza financiare e vitit 2008. Meqë kriza është një sëmundje ekonomike e cila i lënë shtetet të ndryshme të mendojnë dhe krijojnë politika mbrojtëse që deri tani ka rrënuar ekonomi të plota në rruzullin tokësor. Në këtë punim janë shpjeguar se çka është kriza globale financiare, ku dhe kur u shfaq për herë të parë kriza e kohës moderne, si depërtoi në vendet e Evropës si dhe atyre vendeve në tranzicion duke përfshirë Kosovën dhe Shqipërinë, shkaku i kësaj krize dhe si ndikoj në ekonomitë e këtyre vendeve. Për arsye praktike punimi është bazuar kryesisht në analiza të literaturave shkencore në lëmit ekonomike vendore dhe ndërkombëtare, e përcjellë me hulumtime, me ç'rast janë ilustruar analizat dhe krahasimet këtyre dy vendeve të Kosovës dhe Shqipërisë. Të dhënat që janë përdorur në këtë punim janë të dhënat sekondare të nxjerra nga raportet financiare të Bankës Qendrore të Kosovës dhe Shqipërisë, Agjensionit të Statistikave të Kosovës, Institutit Statistikorë të Shqipërisë, Eurostat dhe Bankës Botërore si dhe janë përdorur statistikat të përpunuar kryesisht nga këto institucione mirëpo në punim këto të dhëna janë gjeneruar në metoda të ndryshme.

3. Krizat financiare dhe faktorët që i shkaktuan ato

Krizat financiare përcaktohen si situata e rënies së çmimeve të aktiveve dhe falimentimit të shumë institucioneve financiare dhe bizneseve jo financiare. Është rënia e përgjithshme e çmimit të aksioneve si pasojë e falimentimit të shumë kompanive dhe ndërmjetësve financiarë. Studimi i krizave financiare është i rëndësishëm pasi ato kanë qenë shkak i rënieve të forta ekonomike, situatë e cila është përsëritur edhe në shekullin XXI. Krizat financiare ndodhin kur ka një çarje të sistemit financiar e cila shkaktohet nga një rritje të shpejtë e riskut të ndërgjegjes dhe zgjedhjes së keqe, gjë që bënë të pamundur kanalizimin e fondeve nga kursimtarët tek huamarrësit produktivë. Kjo inefficencë e tregjeve financiare shkakton një tkurrje të shpejtë të aktivitetit ekonomik. Shumë ekonomistë kanë ofruar teoritë se si zhvillohen krizat financiare dhe si mund të parandalohen, ka pak konsensus, megjithatë krizat financiare janë ende një dukuri e rregullt në mbarë botën. Kriza aktuale ekonomike dhe financiare nuk është një fenomen i ri. Kriza nuk dëgjohet për herë të parë dhe nuk është një fenomen i papritur. Me këtë mentalitet jemi mësuar. Sot në vitin 2015, jemi mjaft të familjarizuar me termin krizë. Ajo që përbën risi sot në vitin 2015, për ekonominë dhe për shoqërinë shqiptare, ka lidhje me një fakt tjetër: sot njerëzit e biznesit, pronarët dhe menaxherët e aktiviteteve private, bankierët dhe financierët, ekonomistët dhe gazetarët, dhe me në fund edhe politikanët dhe njerëzit e sektorit publik, ja në më të ndërgjegjshëm se kurrë, për riskun, për shkallën e lartë të vështirësive ekonomike si dhe për nevojën imediate të menaxhimit teknik dhe profesional të këtyre situatave.

3.1 Origjina e krizës globale financiare dhe përhapja e saj në ekonomitë e vendeve në tranzicion

Në vitin 2007, në mënyrë krejt të papritur fjala e tmerrshme “krizë financiare” filloi të përhapej me shpejtësi. Që kishte origjinën nga kreditë e këqija në tregun imobiliar amerikan, ajo dukej se shumë shpejt do të mbulononte me panik gjithë botën. Fjala “subprimes” që deri në këtë periudhë kishte shprehur vetëm njërën nga format e kreditë hipotekare me risk të lartë në SHBA, u bë menjëherë simbol i tmerrshëm i krizës. Personalitete nga më të spikaturit e botës ekonomike e financiare botërore si Alan Greenspan, Dominique Starauss Kahn, Ben Bernanke, Jean Claude Trichet etj. në atë periudhë e trajtuan me shumë prurësi këtë krizë duke cilësuar si “një turbulencë e tregjeve financiare amerikane” që duhet menaxhuar me kujdes në intensitetin dhe përhapjen e saj në Europë dhe vendet tjera të botës. Ndërkaq që Amerika filloi të publikonte llogaritë e para të humbjes financiare marramendëse, bankat dhe tregjet financiare të të gjithë botës filluan të dridhen. Dhe ja asnjë paralajmërim ose shenjë të dukshme që mund të tërhiqte seriozisht vëmendjen, në mëngjesin e korrikut të vitit 2008 ekonomitë dhe sistemet financiare më të fuqishme të planetit filluan rrugën drejt një depresioni të dhimbshëm, më i rëndi i tetëdhjetë viteve të fundit. Filluan debatet mbi shkaqet e krizës, mbi fajtorët që i shkaktuan atë. Duket se në fillim të vitit 2008, penduli i krizës globale financiare që filloi dhe shpërtheu frikshëm e gjerësisht në SHBA filloi të përhapej edhe në Evropë. Kolapsi i tregut të kredive hipotekare solli zhvlerësimin e vazhdueshëm në bursë të aksioneve të institucioneve

financiare, duke bërë që kriza të përcillet në segmente të ekonomisë. Kështu që është reflektuar në një numër të madhe të ekonomive kombëtare në Evropë. Vendet që u prekën menjëherë nga kjo krizë kryesisht Greqia, Spanja, Portugalia Irlanda, sepse këto vende kishin deficit të lartë buxhetor dhe menjëherë u infektuan edhe fushat të tjera që çuan ekonominë në kolaps. U hartuan planet urgjente të veprimit për stopimin dhe kontrollin e saj. Në këtë këndvështrim filluan të hartohen politikat financiare e ekonomike të domosdoshme, u ndërmoren veprimet e menjëhershme e dinamike të mjaft qeverive e bankave qendrore për t'i ngritur asaj të gjitha “barrikatat” e mundshme të përhapjes dhe të infektimit të të gjithë sistemit financiar e ekonomik botëror. Ndikimi i krizës së borxheve të këtyre vendeve është ndjerë tek vendet e Evropës Juglindore, të cilat i kanë këto vende partnerët e tyre kryesorë tregtarë. Meqë Kosova është pjesë e eurozonës mund të ndjejë reflektimet e krizës në disa fusha, ndërsa Shqipëria edhe pse nuk është pjesë eurozonës mirëpo është vend kufitar me Greqinë dhe Italinë dhe konsiderohet si vend partner me këto dy shtete, atëherë edhe ekonomia e Shqipërisë ka ndjerë krizë në disa fusha.

4. Ekonomia e Kosovës nga viti 2008 -2014 sfidat dhe përparësitë


Ekonomia botërore në vitin 2008 u karakterizua me krizë të rëndë financiare, efektet e së cilës u transmetuan edhe në sektorin real të ekonomisë, duke shkaktuar rënie në aktivitetin ekonomik. Viti 2008 për Kosovën ishte një vit i sfidave dhe arritjeve të mëdha. Përkundër një mjedisi të jashtëm jo të favorshëm – të karakterizuar me një krizë financiare të përmasave botërore e më pas të transmetuar në recesion ekonomik – sektori financiar dhe ekonomia e Kosovës vazhduan të jenë të shëndosha, duke reflektuar në disa sektor ritëm rritës. Mirëpo në kohë krize në Kosovë i preku disa indikatorë të sektorit të jashtëm që ishin: Eksportet, Investimet e huaja direkte dhe remitancat apo dërgesat e emigrantëve të cilat këto u ndikuan nga kriza financiare që kishte kapluar Eurozonën. Përrjashtim nga kjo performancë e mirë e sistemit financiar bën Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës, mjetet e të cilit kanë shënuar rënie të konsiderueshme në vlerë si rezultat i rënies së çmimeve të aksioneve në bursat ndërkombëtare. Në këtë punim ne do të analizojmë ekonominë e Kosovës në tre sektor duke identifikuar indikatorët e këtyre sektorëve dhe duke raportuar për gjendjen e tyre ekonomike nga fillimi i krisës viti 2008 e deri në vitin 2014. Duke analizuar se si ka ndikuar kriza financiare gjatë kësaj periudhe në këto sektore.

4.1. Sektori real

4.1.1 Prodhimi i Brendshëm Bruto

E ndodhur përballë krizës financiare dhe recesionit që kaploi ekonominë globale, ekonomia e Kosovës ka arritur t'i rezistojë valës së parë të krizës. Në vitin 2008, Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) ishte 5.7% kryesisht mbështetur nga konsumi privat dhe investimet publike. Mirëpo në vitin 2009 kemi një rënie të PBB në 5,62%, ku në këtë vit u shfaqen efektet e krizës globale financiare duke reflektuar në një normë më të ulët të rritjes ekonomike. Mirëpo në krahasim me vendet tjera botërore themi se kjo normë e rënies ekonomike nuk ishte e madhe. Sipas raporteve themi se kjo rënie u shkaktua si rezultat i rritjes së konsumit dhe investimeve publike të këtij sektori. Ekonomisë e Kosovës vazhdoi me trendin rritës të Kosovës edhe gjatë vitit 2010 PBB ishte 5,74%, ku tregon një normë më të lartë se sa në vitin 2009. Përmirësimi i performancës së ekonomisë globale në vitin 2010 u reflektua edhe në ekonominë e Kosovës, duke ndikuar që sektori privat të jetë bartësi kryesor i rritjes ekonomike. Sistemi bankar i Kosovës kishte rol mjaft të rëndësishëm për financimin e konsumit dhe investimeve në vend. Një tjetër kontribuues mjaft i rëndësishëm për financimin e konsumit në vend ishin edhe dërgesat e emigrantëve, të cilat po ashtu shënuan rritje si rezultat i përmirësimeve në ekonominë e zhvilluara. Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2011 vazhdoi të shënojë normë pozitive të rritjes ekonomike përkundër sfidave të shkaktuara nga luhatjet në ekonominë globale dhe sidomos në atë evropiane.

FIGURA 1. DIAGRAMI I PRODHIMIT TË BRENDSHËM BRUTO GJATË VITIT 2008 – 2013, NË PËRQINDJE




Burimi: BQK

Siç shihet në figurën 1. PBB në vitin 2011 ishte 6,63%, aktiviteti ekonomik në vend u karakterizua me stabilitet ku burimet kryesore të financimit shumica e të cilave treguan performancë të mirë. Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2012 shënoi normë pozitive, në këtë vit PBB u shënuar me 6,45% edhe pse ka një normë më të ulët në krahasim me vitin 2011, sidoqoftë gjatë vitit 2012 kishte luhajtje të theksuar në disa nga burimet e rëndësishme të financimit në vend dhe për këtë arsye ndikuan në rënie të normës së PBB. Zhvillimet në treguesit kryesorë makroekonomikë tregojnë për aktivitet të përsheptuar gjatë vitit 2013 në krahasim me vitin 2012. Rrjedhimisht vlerësimet e BQK-ës janë se rritja reale ekonomike në vitin 2013 ka arritur normën 6,96%. Për dallim nga vitet paraprake, gjatë vitit 2013 janë përmirësimit në neto eksportet që vlerësohen të kenë pasur kontributin kryesor në rritjen ekonomike. Me kontribut kryesor pozitiv është vlerësuar edhe komponenta e konsumit. Gjithashtu edhe komponenta e investimeve ka pasur kontribut kryesor ku të gjitha këto komponenta do ti analizojmë më poshtë.

4.1.2 Çmimet

Stabiliteti i çmimeve në Kosovë, i pranishëm që nga viti 2002, u ndikua ndjeshëm nga presionet e jashtme inflacioniste në fund të vitit 2007 dhe gjatë vitit 2008. Norma mesatare e inflacionit vjetor në vitin 2008 arriti në 9,53%. Kjo ngritje ishte pasojë e ngritjes së çmimeve në nivel botëror. Kjo tregon ndjeshmërinë që ka niveli i çmimeve në Kosovë ndaj sektorit të jashtëm e që është pasojë e mbështetjes së lartë të ekonomisë së Kosovës në importe. Presionet inflacioniste ishin kryesisht pasojë e ngritjes së çmimeve të produkteve ushqimore dhe pjesërisht energjisë në vitin 2008, pasi që norma mesatare vjetore e inflacionit pas përjashtimit të komponentës së produkteve ushqimore dhe energjisë. Gjatë vitit 2008, inflacioni i regjistruar në Kosovë ishte me i lartë krahasuar me vendet e BE-së (3.9 përqind) apo vendet e rajonit (7.6 përqind), kryesisht për shkak se pesha e produkteve ushqimore në shportën e konsumit në Kosovë ishte më e madhe se sa mesatarja e peshës së kësaj kategorie në vendet e BE-së dhe rajonit. Faktor tjetër që ndikoi në shkallën më të lartë të inflacionit në Kosovë ishin kuotat në eksportet e grurit dhe produkteve tjera ushqimore, rritja e çmimit ndikuan në rritjen e inflacionit.

FIGURA 2. DIAGRAM I NORMËS SË INFLACIONIT NË KOSOVË GJATË VITIT 2008 -2014




Burimi: www.tradingeconomics.com/kosovo/inflation-cpi

Në vitin 2009, inflacioni u karakterizua me një normë mesatare të deflacionit prej 2,65%. Indeksi i çmimeve të konsumit u shikua se kishte ndjekur trendet të ngjashme me indeksin e çmimeve të importit duke reflektuar kështu varësinë e ekonomisë së Kosovës në importe. Kjo rënie e çmimeve të importit u karakterizua me rënien e çmimeve të produkteve minerale, artikujve ushqimore, makinerive dhe pajisjeve në nivel ndërkombëtar dhe në nivel vendi si pasojë të kërkesës së përgjithshme. Presionet inflacioniste në nivel global bënë që edhe ekonomia e Kosovës në vitin 2010 të shënoj rritje të inflacionit kështu që norma e inflacionit arriti në 3,49%. Në vitin 2011, inflacioni në Kosovë shënoi një normë mesatare prej 7,4%, kjo tregon se presionet inflacioniste në vend ishin theksuar sidomos në produktet ushqimore dhe çmimet e derivateve të naftës. Viti 2012, u karakterizua me normë të inflacionit prej 2,46%, ndërsa viti 2013 u karakterizua me rënie të normës së inflacionit në 1,76%, gjithashtu ky rënie ka vazhduar edhe në vitin 2014 ku norma e inflacionit u karakterizua me normë prej 0,42%. Shkaku i rënies së shkallës së inflacionit ishte kryesisht nga çmimet e mallrave të importuara gjë që reflekton zhvillimet deflacioniste në vendet e Eurozonës me të cilat Kosova realizon pjesën më të madhe të shkëmbimeve tregtare.

4.1.3 Tregu i punës

Gjendja e tregut të punës në Kosovë mbetet jo e kënaqshme dhe me një shkallë të lartë të papunësisë. Të dhënat e marra nga Eurostat tregojnë që në vitin 2008, norma e papunësisë ishte 40%. Në vitin 2009, norma e papunësisë shihet në rritje kështu që është rritur për 5,4%, në krahasim me vitin e kaluar d.m.th norma e papunësisë është rritur në 45,4%, kjo rritje e normës karakterizohet me reflektimin e papunësisë në Eurozonë dhe duke zvogëluar edhe IHD që kanë për shënjestër fuqinë e lire punëtore.

FIG. 3. NORMA E PAPUNËSISË NË KOSOVË GJATË VITIT 2008-2013



Burim: BQK dhe Agjencia e statistikave të Kosovës


Duke e marrë parasysh rritjen e vazhdueshme të fuqisë punëtore në vend e cila rezulton nga struktura e re e popullsisë, norma aktuale e rritjes ekonomike konsiderohet me kapacitete të ulëta absorbimi për fuqinë punëtore. Kjo normë e papunësisë vazhdon edhe në dy vitet e ardhshme ndërsa në vitin 2012 kemi një rënie të normës së papunësisë në 30,9% dhe në vitin 2013 shënohet me një normë të papunësisë prej 30%. Nga kjo shihet se kemi një rënie të papunësisë me normë prej 0,9%.

4.2. Sektori fiskal

4.2.1 Deficiti buxhetor

Gjatë viteve të kaluara buxheti i Kosovës është karakterizuar kryesisht me suficit. Pamundësia e qeverisë për të marrë borxh publik për shkak të mungesës së ligjit mbi huamarrjen publike dhe mos definimit të statusi politik në vitin 2008, ka kushtëzuar një sjellje më konservative të qeverisë në aspektin e politikave fiskale. Kështu që ekonomia e Kosovës për të financuar ndonjë deficit buxhetor ju neveritnin të përdoronin vetëm tepricat e akumuluar nga vitet e mëparshme. Buxheti i Kosovës në vitin 2008 ishte pothuajse me një deficit prej 8.1 milion euro (0.2% të PBB). Deficiti u shkaktua për shkak të normës së lartë të rritjes së shpenzimeve buxhetore krahasuar me të hyrat. Në vitin 2009, buxheti i Kosovës shënoi deficit prej 85.6 mil euro ose 2.2 % e PBB-së. Në këtë vit u miratua edhe Ligji për Borxhin Publik që i mundësoi Qeverisë së Kosovës të hyjë në obligime kreditore për të financuar deficitin eventual buxhetor si dhe i bënë të mundur emetimin e letrave me vlerë. Sipas ligjit borxhi publik i Kosovës nuk mund të kalojë shumën prej 40% të PBB-së. Mirëpo përpara ligjit, Kosova trashëgoi borxh prej ish-Jugosllavisë në vlerë prej 385.0 milionë euro. Mirëpo disa pjesë Kosova u lirua nga borxhi duke dhuruar donacion SHBA-ja një shumë prej 84.1 mil euro, 5 mil euro dhuroi donacion Komisioni Evropian ndërsa pjesa tjetër i mbet të paguaj Kosova, kështu për dy vitet e ardhme ekonomia Kosova ishte në deficit.

FIG. 4. BUXHETI I KOSOVËS NGA VITI 2008 – 2013



Burim: BQK

Në vitin 2010 deficiti buxhetor shënoi 93.2 ml euro apo 2.2% të PBB-së mirëpo në këtë vit Kosova për herë të parë hyri në aranzhman financiar të FMN-së ku i miratoi Kosovës kredinë e parë në formë “Stand – By –Arrangement”, në vitin 2011

u ulë deficitit buxhetor në 84.5 ml euro apo 1.8% të PBB-së. Në vitin 2012 buxheti i Kosovës u përmyll me suficit prej 71.4 ml euro, përdërisa të gjitha vendet e rajonit u përmyllen me deficit buxhetor. Kosova ishte i vetmi vend në rajon që u përmyll me bilanc pozitiv prej 1.5% të PBB-së. Rritja e bilancit buxhetor ishte kryesisht rritja e të hyrave nga huamarrjet. Ndërsa viti 2013, u karakterizua me rënie të lehtë të hyrjeve dhe rritjeve të shpenzimeve. Në këtë vit buxheti i Kosovës regjistroi deficit prej 152.5 mil euro ose 3.0% të PBB-së.


4.3. Sektori i jashtëm

Në sektorin e jashtëm kam përfshirë indikatorë si normën e importit dhe eksportit, investimet e huaja direkte dhe të ardhurat e transfertat rrjedhëse apo remitanat.

4.3.1 Mallrat dhe shërbimet

Si rezultat i rritjes së vazhdueshme të importeve, bilanci negative tregtar i Kosovës në vitin 2008 në raport me PBB-në arriti në 43%. Në vitin 2008 importi u shënuar me 1837.0 mil euro ndërsa eksporti shënoi një shumë prej 198.5 mil euro. Ndërsa raporti IM me EX ishte 10.8 %. Ky rënie të eksportit shënohet si rezultat i bllokadës së Serbisë dhe Bosnjës për mallrat e Kosovës si dhe rënia e kërkesës dhe çmimeve për shkak të recesionit ekonomik që ka kapluar shumë vende. Në vitin 2009 gjithashtu kemi një rritje të importit dhe rënie të eksportit ky ishte vit ku Kosova kishte përjetuar një rënie të madh të eksportit i cili u karakterizua me deficit të lartë tregtar, si pasojë e krizës globale financiar, ku importi shënonte vlerën prej 1898.7 mil euro ndërsa eksporti shënonte vlerën prej 162.6 mil euro që rezultoi nga zvogëlimi i kërkesës dhe nivelit të çmimeve në nivelin ndërkombëtar dhe problemeve në zbatimin e marrëveshjes së CEFTA-s me Serbinë dhe Bosnje e Hercegovinën. Viti 2010 shënoi një rritje të importit gjithashtu kemi edhe një rritje të eksportit, Kosova filloi zgjerimin dhe rritjen e këmbimit tregtar me botën e jashtme. Gjithashtu edhe në vitet në vijim kemi rritje të importit dhe njëkohësisht një rritje graduale të eksportit. Në vitin 2011, importet shënuan vlerë prej 2,479.3 mil euro dhe eksportet 312.5 mil euro, 2012 importet shënuan vlerë prej 2,036.0 mil euro dhe u zvogëluar në 286.9 mil euro si rezultat i rënies së kërkesës në rajon dhe vendet e BE-së e cila është shkaktuar nga rënia e çmimeve të komponentëve kryesor të cilët importonin Kosova. Viti 2013 shënon një import në shumë prej 2,045.0 mil euro dhe eksport prej 293.9 mil euro.

FIG. 5. BILANCI TREGTAR I KOSOVËS, IMPORTET DHE EKSPORTET E KOSOVËS GJATË VITIT 2008 -2013



4.3.2 Të ardhurat nga transfertat rrjedhëse – Remitanat

Dërgesat e emigrantëve janë një nga burimet më të rëndësishme dhe të qëndrueshme të financimit të jashtëm për vendet në zhvillim. Në dy dekadat e fundit, dërgesat e emigrantëve kanë arritur nivelin e investimeve të huaja direkte (IHD). Në shumë vende në zhvillim, dërgesat e emigrantëve janë edhe më të larta se ndihma nga asistencat e huaja. Ato mbesin të rëndësishme veçanërisht për vendet më pak të zhvilluara, me deficite kronike të mëdha tregtare, duke e zvogëluar këtë hendek. Ngjashëm me vendet tjera, dërgesat e emigrantëve janë të një rëndësie të veçantë edhe për ekonominë e Kosovës. Dërgesat e emigrantëve në Kosovë paraqesin njërin ndër burimet kryesore të financimit të konsumit të ekonomive familjare dhe paraqesin një burim, që siguron gjendje stabile sociale duke zvogëluar ngarkesën ndaj buxhetit shtetëror.

Siç shihet në figurën 6. Shuma e remitanave ishte më e larta në krahasim me gjashtë viteve në vijim themi se kjo ka ndikuar për shkak të krizës globale financiare. Siç e dimë emigrantët nga Kosova kanë emigruar kryesisht drejt vendeve të Bashkimit Evropian për shkak të nivelit më të zhvilluar ekonomik dhe standardit më të lartë të jetës dhe kryesisht në vitin 2009 dhe më tej ishte viti i recesionit ekonomik në vendet e BE-së dhe për këtë arsye edhe Kosova kishte të ardhura nga transfertat shuma të ulëta, ku edhe kjo ka ndikuar në ekonominë e Kosovës.

FIG. 6. REMITANCAT SIPAS VITEVE 2008 – 2013 (NË MILION EURO)




Burimi: BQK

4.3.3. Investimet të huaja direkte

Investimet të huaja direkte janë flukse hyrëse të bilancit të pagesave dhe është tregues i rëndësishëm për rritjen e ekonomive kombëtare.

FIG. 7. INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË GJATË VITIT 2008 -2013 (NË MILION EURO)



Burimi: BQK

Sic po shihet në vitin 2008 IHD kishin vlerën prej 340.4 mil euro ndërsa vitin 2009, 2010 shënuan rënie kryesisht për pasoj të krizës globale e cila ndikoi planet dhe kapacitetet investuese të investitorëve të huaj. Vendet e BE-së, të cilat janë një burim mjaft i rëndësishëm i IHD-ve për Kosovën, ishin ndër vendet të cilat u ndikuan në masën më të madhe nga kriza ekonomike . Kjo pasi që IHD-të në Kosovë vazhdojnë të jenë mjaft të ndjeshme ndaj zhvillimeve në ekonomitë e vendeve të Eurozonës, të cilat njëkohësisht paraqesin burimin kryesor të tyre. IHD-të filluan të shënojnë rikuperim gjatë vitit 2010, ndërsa rritje e theksuar e IHD-ve u regjistrua edhe në vitin 2011. Në figurën 7 shohim prapë një rënie të IHD në vitin 2012 ky përkeqësim i trendit dëshmon për ndjeshmërinë që kanë IHD-të ndaj zhvillimeve ekonomitë e vendeve të eurozonës.

5. Ekonomia e Shqipërisë nga viti 2008 -2014 sfidat dhe përparësitë


5.1 Sektori real

5.1.1 Prodhimi i Brendshëm Bruto

Ecuria e ekonomisë shqiptare është karakterizuar përgjithësisht nga tipare pozitive gjatë vitit 2008. Ekonomia shqiptare ka shënuar ritme të kënaqshme rritjeje ekonomike gjatë vitit 2008, në prani të ruajtjes së treguesve kryesorë të stabilitetit makroekonomik Nën ndikimin e krizës financiare dhe ekonomike botërore, aktiviteti ekonomik në vend ka shfaqur shenja ngadalësimi ndërsa treguesit monetarë kanë patur luhajtje të dukshme. Sipas të dhënave të disponueshme,

aktiviteti ekonomik në vend është karakterizuar nga ritme të larta rritjeje gjatë vitit 2008. Në vitin 2008, Prodhimi i Brendshëm Bruto ishte 12.88 %.

FIG. 8. PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO TË SHQIPËRISË GJATË VITIT 2008 -2013 (NË PËRQINDJE)



Burimi: BQSH

Ndërsa vitet në vijim PBB-ja shënoi ritme rënie ku në vitin 2009 u karakterizua me normë prej 12.4% dhe deri në vitin 2012 kishte ritme rënie ndërsa në vitin 2013 PBB u rrit në 12.9%. Gjithashtu, ambienti i jashtëm ekonomik vazhdoi të mbetet i pafavorshëm për ekonominë shqiptare. Siç shihet në figurën e 8 viti që kishte një rënie të PBB ishte viti 2010, e cila u karakterizua nga euforitë e jashtme të krizës financiare.

5.1.2 Çmimet

Megjithë luhatjet e ndjeshme, viti 2008 u karakterizua nga një stabilitet i kënaqshëm i çmimeve të konsumit. Inflacioni vjetor u karakterizua me një normë prej 3.36% duke qenë brenda tolerancës së Bankës së Shqipërisë prej 2-4 për qind gjatë pjesës më të madhe të vitit. Në këtë kontekst, viti 2009 shënoi një tjetër sukses në kontrollin e inflacionit dhe ankorimin e pritjeve inflacioniste. Norma mesatare e inflacionit gjatë vitit 2009 rezultoi 2.28% ndërkohë që ai është ulatur gjatë gjithë vitit brenda objektivit të BQSH.

FIG. 9. NORMA E INFLACIONIT TË SHQIPËRISË GJATË VITIT 2008-2014 (NË PËRQINDJE)



Burimi: www.tradingeconomics.com/albania/inflation-cpi


Rritja nën potencial e ekonomisë si dhe çmimet e ulëta në tregjet botërore kanë gjeneruar presione të dobëta inflacioniste, duke balancuar efektet negative të nënçmimit të kursit të këmbimit. Kështu me radhë politika monetare inflacioniste në Shqipëri ishte stabile duke qenë intervalit 2-4 për qind. Këto periudha që kishin norma të inflacionit mbi 3% paraqesin goditjet që kanë qenë ardhur nga ecuria e çmimeve të mallrave në tregjet botërore. Tendenca rënëse e inflacionit u përcaktua nga rritja e dobët e kërkesës agregate dhe nga rënia e inflacionit të importuar. Pritjet inflacioniste mbetën të ankoruara pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë.

5.1.3 Tregu i punës

Bazuar në të dhënat zyrtare të disponueshme viti 2008, karakterizohet me një rritje të punësuarve dhe zvogëlim të normës të të papunëve. Norma mesatare e papunësisë në Shqipëri në vitin 2008 ishte 12.75%. Ndërsa viti 2009 dhe 2010 vlerësohet të jenë ndikuar nga ngadalësimi ekonomik i këtyre viteve kështu që norma mesatare e papunësisë është rritur në 13.56% në

vitin 2009 dhe 13.73% në vitin 2010. Siç shihet në fig. 10, vitet 2013 dhe 2014 u karakterizuan me ngadalësim të aktivitetit ekonomik të cilat ndikuan në rritjen e normës së papunësisë ku në vitin 2013 norma e papunësisë ishte 16.37% dhe në vitin 2014 norma e papunësisë ishte 17.92%.

FIG. 10. NORMA MESATARE E PAPUNËSISË NË SHQIPËRI GJATË VITIT 2008-2014 (NË PËRQINDJE)




Burimi: www.tradingeconomics.com/albania/inflation-cpi

5.2. Sektori fiskal

5.2.1 Deficiti buxhetor

Politika fiskale ka patur një karakter më ekspansionist gjatë vitit 2008, duke u reflektuar në rritjen e shpenzimeve publike dhe deficitit buxhetor. Deficiti buxhetor për vitin 2008, vlerësohet të jetë në shumë prej 43.1 milionë euro. Kontribuuesi kryesor në zgjerimin e mëtejshëm të deficitit fiskal, janë shpenzimet për investime, kryesisht ato për infrastrukture rrugën Durrës-Kukës. Deficiti buxhetor arriti vlerën më të lartë në vitin 2009 me shumë prej 57.7 milion euro. Pastaj vitet në vijim deficit buxhetor shënoi rënie deri në shumë prej 47.7 milionë euro. Në figurën e 11 shihet luhatjet e deficiteve buxhetore nga viti në vit.


FIGURA 11. DINAMIKA E DEFICITIT BUXHETOR NË VITE 2008 -2013 (NË MILION EURO)



Burimi: Raport për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2013

Ndërsa figura 12 paraqet shumën e deficitit buxhetor në milionë lekë nga viti 2007 – 2013

FIG12. DEFICITI BUXHETOR I SHQIPËRISË NE LEKË VITI 2007 -2013



Burimi: Raport për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2013


5.3. Sektori i jashtëm

Në sektorin e jashtëm kam përfshirë indikatorë si normën e importit dhe eksportit, investimet e huaja direkte dhe të ardhurat e transfertat rrjedhëse apo remitancat të Shqipërisë.

5.3.1 Tregu i mallrave

Dinamika e tregtisë tregon për ritme të larta rritëse gjatë vitit 2008, si në importe ashtu edhe në eksporte, në vitin 2008 konsiderohet të kenë importuar në shumë 314.2 milionë euro dhe eksportuar në shumë prej 80.4 milion euro. Shuma e importeve dhe eksporteve parashihet një rënie në vitin 2009 ku shuma e importuar kishte rënë në 306.3 milionë euro dhe eksporteve në 74.6 milionë euro. Ku me vitin paraardhës është një ritme e ulët. Kjo rënie konsiderohet si pasojë e krizës globale financiare që ndikoi edhe në tregun e mallrave në Shqipëri. Vitet në vijim shihen një rritje me rritëm të ngadalësuar. Në figurën 13 shihet dinamika e rritjes së importeve dhe eksporteve në Shqipëri gjatë periudhës së saj shtatë vjeçare.

FIG 13. TREGU I MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE TË SHQIPËRISË GJATË VITIT 2008-2014 (NË MILIONË EURO)



Burimi: INSTAT dhe BQSH

Tregu kosovar ashtu si edhe gjatë viteve, vazhdon të thithë pjesën më të madhe të eksporteve të Shqipërisë me rajonin, duke qenë dhe i vetmi vend me të cilin Shqipëria ka suficit tregtar. Partnerë të tjerë tregtarë që po konsolidohen në tregun shqiptar janë Gjermania dhe Rusia.


5.3.2 Të ardhurat nga transfertat rrjedhëse – Remitancat

Totali i dërgesave nga emigrantët, për vitin 2008 vlerësohet të jetë rreth 800 milionë euro, shifër kjo e barabartë me 9.2 përqind të PBB-së. Dërgesat nga emigrantët shënojnë një rënie prej 16 përqind në terma vjetorë. Kriza ekonomike dhe financiare në vendet ku numri i emigrantëve shqiptarë është më i lartë, mendohet të ketë ndikuar në uljen e prurjeve valutore prej tyre. Ndërsa në vitin 2009 kemi një ulje të remitancave në shumë prej 781 milionë euro.

5.3.3 Investimet e huaja direkte

Llogaria financiare gjatë vitit 2008 karakterizohet nga lëvizje të konsiderueshme të kapitalit në të dyja kahet, si në flukset hyrëse ashtu edhe ato dalëse. Investimet e huaja direkte (flukset hyrëse) kanë regjistruar një shifër në vitin 2008, me rreth 680 milionë euro. Në vitin 2009 dhe 2010 kemi një ritëm rritës të IHD.

FIG. 14. INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË SHQIPËRI GJATË VITIT 2008 -2012 (NË MILION EURO)



Burimi: BQSH dhe INSTAT

Në figurën 14 shihet se në vitet 2011 dhe 2012 konsiderohet një rritëm rënëse të IHD që konstatohet nga recesioni nëpërmjet të cilit po kalon Eurozona ka patur një ndikim negativ si në kërkesën e jashtme ashtu dhe në investimet e huaja direkte në të gjitha këto vende.

6. Konkluzione dhe rekomandime

Sipas këtij hulumtimi argumentohet se kriza globale financiare nuk e ka goditur Kosovën dhe Shqipërinë drejtpërsëdrejti edhe pse Kosova ishte pjesë e eurozonës, ekonomitë kanë ndjerë efektet e saj indirekte. Kriza ekonomike e cila u karakterizua në disa nga vendet e eurozonës, nuk ka reflektuar ndonjë efekt të madh negativ në ekonominë e Kosovës. Ky mos reflektim vjen kryesisht si rezultat i një ekspozimi të ulët të sektorit real të ekonomisë së Kosovës ndaj sektorit të jashtëm si dhe në ekspozim të matur të sektorit financiar ndaj sistemit financiar të vendeve të eurozonës. Sipas analizave pamë se në sektorin real Kosova kishte rritje të PBB-së në krahasim me vitet që shumë vende ishin në krizë ndërsa aktiviteti ekonomik në Shqipëri shfaqti shenja ngadalësimi mirëpo në ritme të vogla. Ekonomia e Kosovës dhe e Shqipërisë ndikohen nga tri kanale kryesore nga zhvillimet e vendeve të eurozonës andaj sipas analizës pamë që sektori i jashtëm ishte prekur më shumë nga kriza financiare duke përfshirë: 1. Eksportet, Investimet e huaja direkte dhe dërgesat e emigrantëve. Vendet donatore kanë hezitur të rrisin ndihmën e tyre për shkak të problemeve të brendshme, rritja dramatike e papunësisë në Evropë ka prekur diasporën Kosovare dhe Shqiptare duke ndikuar kështu në rënien e dërgesave të emigrantëve të cilat kanë ndikuar negativisht në ekonominë e Kosovës dhe Shqipërisë. Gjatë reflektimit të krizës në Kosovë dhe Shqipëri e që është prekur sektori i eksportit dhe importit pamë se këto dy vende më shumë kanë importuar se sa eksportuar, kjo ka ndikuar që Kosova të përballet me presione inflacioniste ku normat e inflacionit janë më të larta në krahasim me vendet në rajon dhe në krahasim me vitet të më parshme. Inflacioni në Kosovë është treguar mjaftë i luhatshëm në vitet e fundit duke pasqyruar në masë të madhe zhvillimet e çmimeve në tregjet e jashtme, lidhshmëri kjo që rrjedh nga shkalla e lartë e mbështetjes së ekonomisë së vendit në mallrat e importuara nga jashtë. Investimet e huaja direkte kishin rënie të larta për shkak të recesionit nëpër të cilën kalonte eurozona sipas analizës pamë se IHD shënojnë një rritje të lartë mirëpo të ngadalësuar edhe pse kriza financiare pothuajse ka kaluar. Institucionet janë mjaftë të përgatitura ndaj reagimeve preventive që mund të transmetohen nga krizat, gjatë raporteve pamë që Bankat Qendrore të Kosovës dhe Shqipërisë, Ministrinë e Financave dhe rekomandimet e marra nga FMN-ja dhe BB-ja që tashmë këto dy vende janë anëtare kanë krijuar mekanizma mbrojtës ndaj krizave duke ruajtur stabilitetin makroekonomik dhe fiskal dhe besoi që këto ndikojnë në rritjen pozitive të ekonomisë së Kosovës dhe Shqipërisë.

Bibliografia

- Arestis Philip, Baddeley Michelle & McCombie John (2001), "What Global Economic Crisis?", Palgrave, Great Britain, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës "Raporti Vjetor 2008", Qershor 2009, Prishtinë
 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës "Raporti Vjetor 2009", Qershor 2010, Prishtinë
 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës "Raporti Vjetor 2010", Qershor 2011, Prishtinë
 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës "Raporti Vjetor 2011", Qershor 2012, Prishtinë
 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës "Raporti Vjetor 2012", Qershor 2013, Prishtinë
 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës "Raporti Vjetor 2013", Qershor 2014, Prishtinë
 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës "Analizë mbi mënyrat e dërgimit të remitançave në Kosovë", Prill 2013, Prishtinë
 Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë "Raporti Vjetor 2008", Tiranë
 Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë "Raporti Vjetor 2009", Tiranë
 Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë "Raporti Vjetor 2010", Tiranë
 Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë "Raporti Vjetor 2011", Tiranë
 Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë "Raporti Vjetor 2012", Tiranë
 Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë "Raporti Vjetor 2013", Tiranë
 Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë "Raport zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2013 për", 2014, Tiranë
 Bundo Sherif (2012), "Kriza ekonomike dhe financiare në Rajon dhe në Shqipëri. Pësha e krizës dhe bizneset shqiptare", Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë
 Civici Adrian (2010), "Krizat Financiare apo globale", UET, Tiranë
 Civici Adrian (2013), "Shteti apo tregu", UET, Tiranë
 Charles P. Kindleberger and Robert Aliber (2005), "Manias, Panics and Crashes: A History of Financiar Crises" 5th ed.
 Wiley Kotorri Adriatik & Korbi Alban (2010), "Sistemi financiar", Tiranë

Burimet nga internet:

- <http://www.instat.gov.al/>
<http://www.tradingeconomics.com/>
<https://ask.rks-gov.net/>
<http://ec.europa.eu/eurostat>
<http://www.worldbank.org/>

PROCESI ADMINISTRATIV NË SHQIPËRI

PRANVERA XHAFAJ

PhD Candidate at Tirana European University

veraxhafaj@gmail.com

ABSTRAKT

Thelbin e marrëdhënieve juridike procedurale administrative e përbëjnë gjykata dhe palët, por përveç tyre, në këto marrëdhënie mund të marrin pjesë edhe persona të tretë, të cilët bëjnë pjesë në ndërgjyqësi, si përmbaruesi në fazën e ekzekutimit dhe kur ky proces bëhet pjesë e gjykimit mbi ankim. Me pjesëmarrjen aktive këta kryejnë veprime procedurale në përputhje me normat procedurale administrative, duke ndikuar në " rrjedhën, zhvillimin dhe përfundimin e gjykimit". Ky paragraf do të përbëjë qëllimin dhe objektivat e këtij punimi. Në marrëdhëniet procedurale administrative marrin pjesë disa subjekte të cilët mbartin të drejta dhe detyra të caktuara procedurale të parashikuara nga ligji në fuqi.

Subjekti kryesor në këtë marrëdhënie është gjykata për shkak të rolit të saj vendimtar në zhvillimin e këtyre marrëdhënieve administrative. Gjkata ka një pozitë kryesore dhe të veçantë sepse është vetëm ajo që ka të drejtë të zgjidhë një çështje administrative duke dhënë vendimin përfundimtar. Kjo buron nga fakti që gjykata është i vetmi organ i autorizuar nga ligji për dhënien e drejtësisë dhe si i tillë merr pjesë në mënyrë të detyrueshme në të gjitha marrëdhëniet që krijohen gjatë gjykimit të çështjeve (Av. N.Uka, Av.J.Brati, "Magjistratura & Avokatia", "ILARI" P.F., Tiranë 2012, fq.454.)

Metodologjia e përdorur është ajo cilësore krahasimore të dy doktrinave kryesore mbi procedurën administrative: Vitet e diktaturës (1962) dhe ditët tona (2012). Ky punim do t'i shërbejë studimeve të tjera të fushës në vazhdim pasi Gjkata Administrative është një gjykatë tepër e re në Republikën e Shqipërisë. Dhe se për këtë fakt, librat apo botimet për këtë fushë janë në numër të paktë në Shqipëri.

Fjalë kyç: *gjykatë, marrëdhënie juridike, procedurë administrative, subjekt administrativ.*

Kuptimi i marrdhënieve juridike procedurale administrative

Si subjekte kryesore në një marrdhënie procedurale administrative janë gjykata dhe palët ndërgjyqëse. Këta subjekte si palë aktive (paditësi, kërkuesi) por edhe pasive (i padituri, përsone i tretë, i interesuar) dhe palë mund të kryejnë veprime procedurale në pajtim me normat procedurale administrative duke ndikuar drejtëpërdrejtë por edhe tërthorazi në fillimin, zhvillimin dhe përfundimin e një gjykimi konkret.

Është e pamundur që të kemi marrdhënie juridike procedurale administrative pa ekzistencën e një padie të paraqitur për shqyrtim gjyqësor. Subjektet që ndërhyjnë në këtë marrdhënie juridike procedural administrative ndërhyjnë ose janë të detyruara të ndërhyjnë vetëm brenda procesit gjyqësor i cili është iniciuar me padi. Marrdhënia juridike administrative nuk varet nga procesi gjyqësor administrativ pasi realizohet pavarësisht nga procesi gjyqësor si dhe jashtë procesit gjyqësor si një marrdhënie me vetë në një gjykatë të pavarur dhe jo me si pjesë e seksionit të saj.

Marrdhënia juridike procedurale administrative, realizohet brenda procesit gjyqësor apo brenda gjykimit. Në procesin gjyqësor marrin pjesë edhe përsone të tjera si mbajtësi i procesverbalit gjyqësor që mbahet nga sekretaria gjyqësore, përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse, avokatura e shtetit si palë që mbron interes e palëve në gjykim, dëshmitarët, ekspertët dhe përkthyesit, por këta nuk janë subjekte direkt të procesit gjyqësor administrativ pasi ata me pjesëmarrjen e tyre nuk kanë të njëjtin ndikim si palët ndërgjyqëse pasi ata në fakt kanë vetëm një rol ndihmës në veprimet e subjekteve të procesit.

Marrdhënia juridike procedurale administrative, është më i gjërë se procesi gjyqësor administrativ. Për kuptimin e marrdhënies juridike procedural administrative janë dhënë përkufizime të ndryshme duke u përpjekur që të përfshijnë elementët themelor të tij. Por përgjithësisht mund të thuhet se marrdhënia juridike procedural administrative është marrdhënia e posaçme midis gjykatës dhe subjekteve të tjera procedurale, të cilët janë të lidhur me të drejta dhe detyra të caktuara procedurale nga normat e së drejtës procedurale administrative.

Me marrdhënie juridike procedurale kuptohet tërësia e të drejtave dhe detyrave të subjekteve pjesëmarrës në procesin gjyqësor me palë kundërshtarë, në procesin gjyqësor administrativ.

Subjektet e marrdhënieve juridike procedural administrative

Në gjykimin administrativ në zhvillimin dhe në zgjidhjen e çështjes administrative marrin pjesë gjykata, palët ndërgjyqëse, në disa raste përsone të tretë si ekspertet. Këta quhen subjekte të gjykimit administrativ që kanë të drejta dhe detyra procedurale të caktuara dhe që me veprimet e tyre influencojnë rrjedhimin zhvillimin dhe përfundimin e gjykimit.

Në gjykimin administrativ marrin pjesë edhe të tjerë si përkthyesit, dëshmitarët dhe ekspertët. Por këta nuk influencojnë me pjesëmarrjen e tyre në zhvillimin e gjykimit por vetëm ndihmojnë veprimtarinë e pjesëmarrësve të tjerë në njoftimin e fakteve ose njohuritë e tyre teknike ose shkencore. Prandaj këto nuk janë subjekte të gjykimit (*A.Lamani, "Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë", Tiranë 1962, fq.27.*).

Në terminologji dhe në analogji të ligji procedural, konkretisht duke i'u referuar neni 15 të Ligjit me nr. 49/2012 "*Për Organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" (Ligji Nr. 49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative në Shqipëri*).

Gjykata Administrative

Gjykata si subjekt i marrdhënies juridike procedural administrative, ka një pozitë të veçantë dhe më kryesorën pasi është e vetmja që ka autoritetin që të zgjidhë një çështje administrative më anë të një vendimi përfundimtarë (*Av.N.Uka, Av.J.Brati, "Magjistratura & Avokatia", "ILARI" P.F., Tiranë 2012, fq.454.*).

Gjykata, ka rol organizues dhe drejtues gjatë gjithë procesit gjyqësor administrative madje pa të nuk mund të mendohet zhvillimi dhe përfundimi i procesit, si dhe ka një rol pasiv gjatë gjykimit. Gjykata si subjekt ka të drejta dhe detyra të përcaktuara në një proces gjyqësor konkret administrativ. Detyra kryesore e gjykatës është të shqyrtojë si dhe të japë vendime për çdo çështje që i paraqitet për shqyrtim me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë (*neni 1 paragrafi i dytë i Kodit të Proçedurës Civile*).

Gjithashtu gjykata ka dhe detyra të karakterit juridiko procedural si ajo është e detyruar të shprehet për të gjitha kërkimet e pretendimet e palëve dhe vetëm brenda kufijve të asaj që kërkohet. Vendimin e saj duhet ta mbështesë vetëm në faktet që janë paraqitur nga palët në procesin gjyqësor, si dhe të kryejë një hetim të plotë e të gjithanshëm, ç'ka tregon një rol jo aktiv të gjykatës, por më shumë si një detyrë që ajo tu japë palëve mundësi të provojnë kërkimet dhe propozimet e tyre.

Kanë qënë jo të pakta rastet kur ky parim nuk është kuptuar drejt duke u konfunduar me çështjen e juridiksionit dhe kompetencës.

Në rast se ligji mungon apo ka boshllëk juridik që nënkupton se për çështjen e caktuar nuk ka një dispozitë ligjore procedurale që parashikon shqyrtimin e saj nga gjykata dhe çështja nuk hyn në juridiksionin e organeve të tjera gjykata është e detyruar të pranojë çështjen për shqyrtim dhe të japë një vendim duke u bazuar pikërisht në këtë parim si dhe në normat e tjera të përgjithëshme parimore të cilat rregullojnë çështje të tjera analoge. Madje edhe në rastet kur nuk gjendet asnjë zgjidhje e shkruar në një akt ligjor apo nënligjor si dhe as në një vendim gjykata analog gjykata zbaton drejtëpërdrejtë Kushtetutën për

shkak se është e detyruar të plotësojë të drejtën e shkelur apo të munguar të pretenduesit (*Kodi Procedurave Administrative*).

Gjykata është subjekt i procesit gjyqësor dhe si i tillë ka të drejtë dhe detyrë të marrë masa për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor, të kërkojë nga palët pjesëmarrëse kryerjen e veprimeve procedurale, të marrë masat për sigurimin e provave kur palër e kanë të pamundur për ti paraqitur si dhe të ngarkojë me përgjegjësi palën që përpiqet të pengojë zhvillimin normal të procesit apo zgjatjen dhe ndërlikimin e tij.

Gjykata ushtron pushtetin gjyqësor në mënyrë të pavarur duke qënë një organ kushtetues.

Palët dhe personat e tretë në procesin civile si subjekte të marrdhënies juridike procedurale civile.

Neni 90 paragrafi i parë i Kodit të Proçedurës Civile, përcakton: “*Palë në një gjykim administrativ janë personat fizike ose juridikë në emër ose kundër të cilëve zhvillohet gjykimi*” (Neni 90 paragrafi i parë i Kodit të Proçedurës Civile).

Një arguemntin dhe përkufizim i tillë nënkupton se palët janë subjekte të marrdhënies juridike procedurale administrative pasi pa to nuk mund të ketë proces administrativ dhe me cilësinë e subjekteve ato gëzojnë të drejta dhe ngarkohen më disa detyra.

Ata janë të detyruar të kryejnë veprime procedurale në formën e kërkuar nga ligji, të ruajnë respektin që dikton procesi gjyqësor, nuk lejohen që të përdorin shprehje të papërshtatshme ose fyese pasi në rast të kundërt parashikohen sanksione për shkelje të këtij ndalimi. Padia në vetvete duhet të plotësojë disa kërkesa të parashikuara nga ligji administrativ pasi në rast të kundërt gjykata jep kohë për plotësim të metash dhe në rast se edhe atëherë nuk i plotëson brenda afatit atëherë ka të drejtë të kthejë kërkesë padinë (*Floqi, Kristo, “Administrata ose E Drejta Sundimore” Pjesa e përgjithshme, Shtypshkronja Vlora, 1923*).

Pala që i drejtohet me padi kundër një ose disa personave të tjerë fizik apo juridik duke kërkuar mbrojtjen e të drejtave ose interesave të ligjshëm që pretendon se i mohohen ose i cënohen vënë në lëvizje gjykatën e cila nga ana e saj është e detyruar të kufizohet në shqyrtimin vetëm të çështjeve që ngrihen nga palët.

Personi që i drejtohet gjykatës për të kërkuar njohjen ose rivendosjen e një të drejte që pretendon se i mohohet ose i shkelet nga një organ administrativ të cilin e thërret rregullisht para gjykatës quhet paditës. Ndërsa personi tjetër që thirret në gjykatë për t’iu përgjigjur se sipas pretendimit të personit që e thërret në gjykatë ka mohuar ose ka shkelur një të drejtë të këtij quhet i paditur. Të dy këta dmth paditësi dhe i padituri quhen palë ose ndërgjyqës, ose palë ndërgjyqëse (*A.Lamani, “Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë”, Tiranë 1962, fq.29*).

Në ato raste kur çështja mund të ketë interes për persona të tjerë të cilët nuk marrin pjesë në proces atëherë për të shmangur shqetësimin e përsëritjen e procesit të gjykimit personave të tretë u është dhënë mundësia e ndërhyrjes në këtë proces si palë. Personi i tretë mund të ndërhyjë duke u paraqitur kundër të dy palëve ndërgjyqëse ose duke ju bashkuar njërës palë kundër palës tjetër dhe dukë marrë kështu cilësinë e subjektit të marrdhënies juridike procedural administrative. Kjo ndodh vetëm atëherë kur ka për të mbrojtur një interes të tij të ligjshëm pasi në rast të kundërt nuk mund të pranohet ose nuk mund të thirret.

Palët karakterizohen nga fakti:

Se gjykimi zhvillohet në emër të tyre dhe kundër tyre në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të tyre administrative;

- Se fuqia e vendimit gjyqësor në lidhje me konfliktin mbi të drejtat administrative shtrihet mbi ta;

Se ata si rregull kanë në ngarkim shpenzimet gjyqësore. (*A.Lamani, “Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë”, Tiranë 1962, fq.30*.)

Subjektet ndihmëse që bëjnë pjesë në marrdhëniet juridike procedurale administrative

Subjektet që marrin pjesë në një marrdhënie juridike të një procesi gjyqësor administrative, me kërkesë të palëve apo të thirru nga gjykata si subjekte që kanë interes në çështje, janë ato që nuk marrin përsipër pasojat e procesit por japin ndihmesën e tyre për palët dhe gjykatën për realizimin e procesit dhe përfundimin e tij, ku mund të përmendim thirrja e personave të tretë, thirrjen si palë të interesuar avokaturën e shtetit, si dhe subjekte që japin ndihmesë në procesin gjyqësor.

Gjithashtu si subjekte të tillë mund të përmendim edhe sekretarinë gjyqësore që mban procesverbalin gjyqësor, dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit etj. Proçesi gjyqësor është i gjërë dhe si i tillë mund të prekë fusha të ndryshme të jetës të cilat kërkojnë mendim të specializuar të ekspertëve të fushës përkatëse.

Eksperti është një subjekt i domosdoshëm në raste konfliktesh pronësie, apo rastet kur palë në proces janë persona që nuk e njohim gjuhën shqipe apo kemi akte që nuk janë në gjuhën shqipe dhe në këtë rast kërkohet domosdoshmërisht prezenca e një përkthyesi për zhvillim normal gjyqësor dhe një hetim të plotë e të gjithanshëm të çështjes objekt gjykimi.

Këta aktor hyjnë në marrdhënie procedurale, pasi veprimet e tyre kushtëzohen nga procedurat dhe ndihmojnë procesin gjyqësor dhe subjektet e tij por nuk janë subjekte të procesit.

Përmbajtja e marrdhënies juridike procedurale administrative

Përmbajtja e marrdhënies juridike procedurale administrative e përbën në vetvete tërësinë e të drejtave dhe e detyrave të subjekteve të këtyre marrdhënies dhe raporti midis të drejtave dhe detyrave që lindin gjatë zhvillimit të procesit administrativ. Ushtrimi i këtyre të drejtave dhe përmbushja e detyrave në procesin administrativ siguron zhvillimin e një procesi të rregullt.

Palët ndërgjyqëse në gjykimin administrativ kanë të drejta procedurale dhe detyra procedurale të caktuara, detyrat procedurale parashikohen në mënyrën gjenerike dhe vetëm pak prej tyre në mënyrë të veçantë (*A.Lamani, "Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë", Tiranë 1962, fq.36.*)

Të drejtat procedurale administrative janë mundësia që u njeh ligji subjekteve të marrdhënies juridike procedurale administrative për të kryer veprime procedurale sipas dispozitave ligjore si p.sh e drejta e paditësit të ngreje padi etj, e drejta e të paditurit për të të provuar ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë; të provojë ligjshmërinë e veprimeve në marrdhënien e punës, nga e cila ka lindur mosmarrëveshja, objekt gjykimi; Në rastet e tjera, pala ka detyrimin të provojë faktet, në të cilat bazon pretendimin e saj.

Por edhe në këto raste, gjykata, edhe kryesisht, me vendim të ndërmjetëm, mund të vendosë kalimin e barrës së provës tek organi publik, kur ka dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova me shkrësë, që vërtetojnë se organi publik fsheh apo nuk paraqet me dashje fakte dhe prova të rëndësishme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Ky vendim ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar.etj.

Detyrat procedurale administrative janë ato veprime procedurale që subjektet e marrdhënies juridike procedurale detyrohen të kryejnë si psh gjykata ka detyrë të zgjidhë çështjen me vendim gjyqësor, paditësi ka detyrë të plotësojë të metat e padisë, palët detyrohen ti bëjnë të njohur njëra-tjetrës provat mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre etj (*Çomo, Jani, "E drejta Administrative e Republikës së Shqipërisë" libri i tre- te, botim i vitit 1983.*)

Në mënyrë që të kuptojmë përmbajtjen e marrdhënies juridike procedurale administrative duhet të sqarohet dallimi midis subjekteve të marrdhënies juridike procedurale administrative dhe subjekteve të procesit gjyqësor administrativ.

Subjekte të marrdhënies juridike procedurale administrative janë gjykata, pala paditëse, pala e paditur, personat e tretë që ndërhyjnë ose thirren në proces, sekretari gjyqësor, dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit, gjykata e tjera që kryejn veprime me delegim, përmbaruesi që merr pjesë në ekzekutim si personat e tjerë që marrin pjesë në këtë fazë. Ndërsa subjekte të procesit gjyqësor administrativ janë ato që marrin përsipër pasojat e procesit që janë gjykata dhe palët. Subjekte të marrdhënies juridike procedurale administrative janë të gjithë ata që për shkak të ligjit, apo të rrethanave hyjnë në marrdhënie procedurale me njëri tjetrin dhe me gjykatën, realizojnë veprime procedurale administrative, ndërsa subjektet e procesit gjyqësor ndryshe nga subjektet ndihmëse marrin përsipër dhe realizojnë pasojat e procesit gjyqësor të konkretizuara me vendim të gjykatës.

Procesi gjyqësor administrativ është pjesë e marrdhënies juridike procedurale administrative. Subjektet e tij bëjnë pjesë në këtë marrdhënie. Ndërsa marrdhënia juridike procedurale administrative është një fushë më e gjërë se procesi gjyqësor dhe e përfshin këtë të fundit brenda saj. Pra jo të gjithë subjektet e marrdhënies janë subjekte dhe të procesit.

Subjektet që marrin pjesë në procesin gjyqësor juridiko-administrativ dhe veprimet procedurale të subjekteve të procesit gjyqësor

Procesi gjyqësor administrativ, realizohet ndërmjet një, dy ose më shumë personave të cilët vihen përballë njëri-tjetrit para një subjekti të veçantë i ngarkuar me zgjidhjen e një çështje administrative me vendim përfundimtarë. Që të kemi një proces administrativ duhet detyrimisht tre subjekte në rast se gjykimi zhvillohet me dy palë.

Procesi gjyqësor administrativ ka palë të saj paditësin, të paditurin (organin administrativ) dhe të ashtuquajturin personë të tretë, që ndërhyjnë vullnetarisht për të mbrojtur interes e tyre ose që janë të detyruara të ndërhyjnë pasi janë garanci për të paditurin (*Av.N.Uka, Av.J.Brati, "Magjistratura & Avokatia", "ILARI" P.F., Tiranë 2012, fq.551.*)

Paditësi në procesin gjyqësor administrativ është personi që i drejtohet gjykatës me padi për të kërkuar njohjen ose rivendosjen e një të drejte që pretendon se i është shkelur ose mohuar nga një organi publik të cilin me padi e thërret në gjykatë duke e cilësuar si të paditur.

Të paditurin e thërret paditësi me padi ndërsa gjykata si organ shtetëror në proces ka një pozitë të veçantë pasi është i vetmi organ që shqyrton një çështje administrative dhe jep vendim përfundimtarë dhe që caktohen pavarësisht vullnetit të palëve. Në procesin gjyqësor këto janë subjekte e domosdoshëm pasi pa ta nuk ka proces por pjesë e procesit mund të bëhen edhe personat e tretë të cilët mund të ndërhyjnë ose mund të thirren si të tillë në rast se me objektin e padisë objekt shqyrtimi kanë interesa.

Personat e tretë mund të ndërhyjnë me kërtime kundrejt të palëve në proces ose mund ti bashkohen njëerës palë përkundrejt palës tjetër. Të gjithë këto pjesëmarrës kryejnë veprime procedurale të cilët përbëjnë përmbajtjen e procesit administrativ. Palët dhe subjektet e tjerë që marrin pjesë për të mbrojtur interes e tyre kryejnë veprime procedural me qëllim që gjykata të zgjidhë mosmarrëveshjet midis tyre. Nga kryerja ose moskryerja e këtyre veprimeve rrjedhin pasojat procedural konkrete. Veprimet procedurale të palëve janë të rregulluara nga ligji.

Ndërsa gjykata ka pozicion ndryshe pasi ajo ka si detyrë zgjidhjen përfundimtare të çështjes objekt shqyrtimi, të kryejn veprime procedural të caktuara për zgjidhjen e çështjes të cilat përgjithësisht janë të detyrueshme për pjesëmarrësit në proces.

Veprimet procedurale të gjykatës duhet të dallohen nga veprimet procedurale me karakter përgatitor nga ata me karakter vendosës. Veprimet përgatitore kanë si synim të përgatisin sa më mirë procesin për gjykim pasi kjo ndihmon në zgjidhjen e shpejtë të çështjes. Ndërsa në veprimet procedurale vendosëse gjykata synon të zgjidhë një çështje të pretenduar.

Veprimet procedurale që kryejnë palët ose personat e tretë dallojnë me veprime të kushtëzuara me afat dhe me veprime të revokueshme ose të parrevokueshme.

Në veprimet proçeduriale që janë me afat, mosrespektimi i këtij afati sjell humbjen e së drejtës për kryerjen e këtyre veprimeve (Floqi, Kristo, “*Administrata ose E Drejta Sundimore*” Pjesa e përgjithshme, Shtypshkronja Vlora, 1923).

Veprimet proçeduriale të revokueshme sjellin efekte të tërthorta siç janë ankimi, padia etj. Është e përcaktuar se heqja dorë nga padia apo ankimi mund të bëhet në çdo kohë deri në çastin e dhënies së vendimit të formës së prerë. Veprimet proçeduriale të parevokueshme janë ato me efekt të drejtëpërdrejtë sepse në çastin e lindjes së tyre vjen pasoja proçeduriale e parashikuar në ligj p.sh revokimi nga heqja dorë nga ankimi nuk mund të ndodhë.

Ndërsa kur pala paraqet ankim kundër vendimit përfundimtarë veprimi është i revokueshëm sepse pala mund të revokojë të heqë dorë nga ankimi por veprimi i heqjes dorë është i parevokueshëm, nuk mund të hiqet dorë prej tij sepse procesi gjyqësor është mbyllur dhe pasoja vjen menjëherë. Të parevokueshëm janë përgjithësisht veprimet proçeduriale disponibël në të cilat pala që i kryen e keqëson pozitën e vet proçeduriale, pasi po të njihej mundësia e revokimit do sillte si pasojë pasiguri për pozitën e palës tjetër dhe zvarritje pafund të procesit.

Bibliografia

Çomo, J., “*E drejta Administrative e Republikës së Shqipërisë*” libri i tre- te, 1983, Tiranë.

Floqi, K., “*Administrata ose E Drejta Sundimore*” Pjesa e përgjithshme, “Vlora”, 1923, Vlorë.

Lamani, A, (1962), “*Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë*”, Tiranë.

Uka, N (Av.), Brati, J, (Av.), 2012, “*Magjistratura & Avokatia*”, “ILARI” P.F., Tiranë.

Ligje

Kodi Procedurave Administrative

Kodi Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë, 2008

Ligji Nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative në Shqipëri”

ANALIZA E NEVOJAVE TË BANKAVE PËR GJUHË ANGLEZE DHE KOMUNIKIM

ELSA ZELA

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Pedagogji

ABSTRAKT

Shekulli i njëzetë dhe shtrirja globale e tregtisë dhe ekonomisë, çoi drejt një bote të marrëdhënieve ndërkombëtare në lidhje me aspekte të ndryshme të komunikimit, shkëmbimin e informacionit me anë të shkencës dhe teknologjisë, duke komunikuar përmes aktiviteteve komerciale dhe gjithashtu duke udhëtuar në botë për arsye të ndryshme. Kërkesa për gjuhë angleze ka qenë në rritje të vazhdueshme, veçanërisht, në vendet ku Anglishtja mësohet si gjuhë e huaj (Hutchinson dhe Waters, 1987).

Ky studim përqendrohet rreth dy çështjeve kryesore të gjuhës angleze për qëllime komunikimi të bankave në Shqipëri: a) aftësitë e gjuhës angleze që punonjësit e bankave përdorin me tepër në ambientet e tyre të punës; dhe b) vështirësitë që punonjësit e bankave hasin në kryerjen e veprimeve të kërkuara në punë. Si rrjedhojë synon të japë një pasqyrë ku shihet nëse “kërkesa” për gjuhë angleze dhe komunikim është e nevojshme për të kryer funksionet e përditshme në një bankë përputhet me “ofertën”, aftësitë dhe kompetencat që personeli i bankës ka përftuar gjatë studimit të gjuhës angleze në universitet apo në institucione të tjera arsimore.

Me anë të intervistave dhe pyetësorëve është synuar të përcaktohen aftësitë e gjuhës angleze që punonjësit e bankave kërkojnë të përdorin në ambientet e punës si edhe shkalla e vështirësisë që hasin në kryerjen e detyrave të kërkuara. Të intervistuarit në këtë studim përfshijnë punonjës të bankave në nivelin e stafit, menaxherë dhe drejtues ekzekutivë.

Fjalë kyç: *Aftësi të gjuhës angleze, analizë nevojash, banka, aftësi komunikimi*

Hyrje

Asnjë gjuhë nuk ka aq ndikim aq të madh sa gjuha angleze, e cila është bërë një gjuhë e zakonshme midis njerëzve nga vende të ndryshme dhe në fusha të ndryshme, qe nga politika, kultura, tregtia dhe teknologjia. Studiuesja McCrum (2010) deklaroi se “Anglishtja përdoret tani, në një formë apo një tjetër, nga afërsisht katër miliardë njerëz në tokë, ndoshta dy të tretat e planetit, përfshirë 400 milion folës amtare angleze, “ (P.33). Si rrjedhojë, në shumicën e rasteve, kjo është “një” gjuhë kontakt ‘ndërmjet personave që nuk ndajnë as një gjuhë të përbashkët amtare, as një kulturë të përbashkët, dhe për të cilët Anglishtja është gjuha e huaj e zgjedhur për komunikim “(Firth, 1996). Si anëtare i komunitetit botëror ashtu edhe si vend kandidat për Bashkimin Europian, Shqipëria nuk bën përjashtim. Ashtu si edhe në shume vende të tjera të Bashkimit Evropian, edhe në Shqipëri për shkak të përdorimit të saj të gjerë, të paturit njohuri të mira të gjuhës Angleze po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme për konkurrencën që të ofron tregu i punës. Analiza e nevojave erdhi si rezultat i një kërkese për kurse të gjuhës angleze të drejtuara rreth nevojave specifike të nxënësve pas luftës së dytë botërore. Ndër kontribuuesve me të mëdhenj në konceptin e analizës së nevojave është Munby. Munby (1978) në hartimin e tij programit komunikativ paraqiti një grup shumë të detajuar procedurave për zbulimin e nevojave të situatës së synuar, d.m.th, çfarë nxënësi duhet të bëjnë në një situatë të caktuar. Për të, nevojat janë ‘domosdoshmëri’, ‘mungesa’ dhe ‘dëshira’. Domosdoshmëritë janë llojet e nevojave të përcaktuara nga kërkesat e situatës së synuar, d.m.th, ajo që nxënësi duhet të dijë në mënyrë që të veproje sa më mire në një situatë të synuar p.sh. nevojat që mund të ketë një biznesmen/e për të komunikuar në mënyrë efektive tek shitjet, etj. ‘Mungesat’ janë domosdoshmëritë të cilat nxënësi nuk i ka, ndërsa ‘dëshirat’ janë dëshirat dhe pikëpamjet e nxënësve në nevojat e situatës së synuar.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Ky studim synon të hedh dritë mbi aftësitë e gjuhës angleze të cilat kërkohen nga punonjësit në sektorin bankar. Në mënyrë të veçantë, studimi përqipet të zbulojë disa nga mënyrat dhe funksionet e përdorimit të gjuhës angleze për komunikim të cilat punonjësit në departamente të ndryshme në shtatë banka në Tiranë i konsiderojnë si të nevojshme për të kryer funksionet e tyre në mjediset e tyre të përditshme të punës. Nëpërmjet pyetësorëve, të plotësuar nga më shumë se 170 punonjësish në këto 7 banka, studimi përqipet për të përcaktuar se cila është përqindja e detyrave të përditshme të cilat kërkojnë komunikim në gjuhën angleze dhe cilat janë aftësitë e gjuhës angleze që përdoren më shpesh. Gjithashtu, është bërë një përpjekje për të përcaktuar shkallën e vështirësisë që këta punonjës hasin në përdorimin e gjuhës angleze për të kryer këto detyra të ndryshme. Ky studim do të diskutojë vetëm gjetjet deri në këtë pikë të studimit. Në shkallë më të gjerë, ky studim i cili është pjesë e punimit tim të doktoraturës, do të përdoret me të dhënat e marra për t’u krahasuar me tëj me programin e lëndës së gjuhës angleze për qëllime specifike në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Krahasimi do të bëhet në aspektin e shqyrtimit nëse njohuritë që jepen në universitet përputhen me njohuritë e nevojshme në vendin e punës. Me anë të kësaj analize të përputhjes ose të mospërputhjes së aftësive të gjuhës Angleze të informohen hartuesit e programit të lëndës si edhe punëdhënësit e bankave për të adresuar më mirë nevojat gjuhësore të punonjësve të bankave në Tiranë.

Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Në këtë studim është përdorur një qasje sasimore e cila me anë të teknikave sasimore është shfrytëzuar për të studiuar nevojat për gjuhë angleze të punonjësve të bankave në Tiranë. Metoda kryesore e përdorur në studim është pyetësori. Pyetësori përbëhet nga një shkallë vlerësimi e tipit Likert. Të dhënat u analizuan sipas teknikave statistikore dhe si pasojë gjetjet u interpretuan objektivist. Si pikënisje studimi filloi me një analizë të dokumenteve të marra nga burime informacioni në lidhje me sektorin e bankave dhe financës në Shqipëri. Dokumentacioni përfshin raportet vjetore si edhe informacione të tjera të postuara në faqet zyrtare në internet të 16 bankave të cilat kanë aktivitet në Shqipëri. Më tej studimi vazhdoi me intervistën e dy ekspertëve fushës së ekonomisë dhe financave të punësuar në Dhomën e Tregtisë dhe Bankën e Shqipërisë. Intervista me dy ekspertet e ekonomisë u bë me qëllim që të fitohet një përshkrim i hollësishëm performanceve në punë të pozicioneve të ndryshme në sektorin e bankave. Në baze të intervistës me ekspertët e fushës u krijua një ide e përgjithshme e përmasave të analizës së nevojave si edhe u krijua korniza e cila do të ishte themeli për krijimin e pyetësorit gjysmë të strukturuar i cili do të nënshtrohej me pas personelit të bankave. Më tej u përshtat një version i modifikuar i përdorur nga Bhatia dhe Candlin në studimin e tyre mbi nevojat për komunikim për profesionistët në fushën e drejtësisë në Hong Kong (Bhatia & Candlin, 1998). Pyetësori u administrua në një kampion prej 170 punonjësish të bankave të punësuar në departamente të ndryshme në nivelin administrativ dhe jo menaxherial. Në shkurt 2015, u dërguan e-maile 16 bankave në Tiranë duke kërkuar pjesëmarrjen e tyre në studim. Pas disa përpjekjeve të përsëritura, 7 nga këto banka, 3 lokale që operojnë vetëm në Shqipëri dhe 4 me përfaqësim ndërkombëtar u përgjigjën pozitivisht pjesëmarrjes në studim. Megjithatë, gjetjet nga shtatë bankat që kanë marrë pjesë në studim kanë sjelle të dhëna shumë të pasura dhe interesante. Pyetësorët e përfutur nga kampioni prej 170 punonjësish sjellin detaje dhe aspekte të ndryshme të punës së tyre dhe gjuhën e përdorur. Para administrimit të pyetësorit, punonjësit janë siguruar se ky studim zhvillohet thjesht për qëllime kërkimore, të dhënat janë konfidenciale duke u ruajtur anonimati dhe përgjigjet e tyre nuk do të diskutohen me stafin menaxherial të bankave.

Pyetjet kërkimore

Cilat janë aftësitë e gjuhës angleze që punonjësit e bankave përdorin më tepër në ambientet e tyre të punës?
 Cilat janë veprimet/detyrat të cilat përfshihen në komunikim në gjuhën angleze?
 Cilat janë vështirësitë e hasura në kryerjen e veprimeve të kërkuara?

Analizë, interpretim të dhënash

Kjo pjesë paraqet një informacion të përgjithshëm të 170 pjesëmarrësve të cilët përfunduan dhe kthyen pyetësorët. Pjesa e “Informacion i përgjithshëm” i pyetësorit ishte e ndarë në dy seksione. Pjesa e parë është për të dhënat personale të pjesëmarrësve të cilat kanë lidhje me gjininë, moshën, arsimimin, kohëzgjatjen e punës në bankë, dhe pozicionin e punës në të cilën punojnë. Seksioni i dytë përshkruan informacione në lidhje me rëndësinë që ka gjuha angleze në pozicionin e tyre të punës si dhe niveli i tyre aftësive në gjuhën angleze .

TABELA 1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR PJESËMARRËSIT: GJINIA, MOSHA, ARSIMIMI, KOHËZGJATJA E PUNËS NË BANKË, DHE POZICIONI I PUNËS.

Informacion i përgjithshëm	Frekuenca	Përqindja
Gjinia		
Mashkull	60	35%
Femër	110	65%
Totali	170	100%
Mosha		
21- 30	24	14
31-40	72	42
41-50	61	36
51-60	13	8
Total	170	100%
Arsimi		
Më ulet se Bachelor	0	0
Bachelor	109	64.4
Master	60	35
Doktoraturë	1	0.6
Total	100	100%
Kohëzgjatja e punës në bankë		
Më pak se 1 vit	7	4
1-5 vjet	32	10
6-10 vjet	39	24
Më shumë se 10 vjet	92	52
Total	170	100%
Pozicioni i punës		
Menaxhim	24	14
Politikat dhe strategjia e Korporatës	12	6
Investime	6	4
Menaxhimi financiar	4	3
Kredia metropolitane	4	3
Kredia rajonale	5	2.5
Depozita dhe Shërbimi Bankar	22	13
Teknologjia e informacionit	9	5
Financë	32	19
Mbështetje për kredi	21	12
Mbështetje operacionale	31	18.5
Total	170	100%

Tabela 1 tregon frekuencën dhe përqindjen e informacionit personal të pjesëmarrësve në lidhje me gjininë e tyre, moshën, arsimin, kohëzgjatjen e punës në bankë si edhe departamentin në të cilin punojnë. Siç mund të shihet, shumica e pjesëmarrësve janë femra (65%), kurse 35% janë meshkuj. 42 % e pjesëmarrësve i përkasin kategorisë 31-40 vjeçare dhe pjesëmarrësit të moshës 51-60 vjeçare ishin më të pakët në numër (8 %). Në lidhje me arsimin, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve (64,4%) kanë një diplomë bachelor, 35 % mbajnë një diplomë master, nuk rezultoi asnjë punonjës me nivel më të ulët se diploma bachelor, dhe vetëm një prej tyre kishte gradën Doktor. Shumica e pjesëmarrësve (52 %) punojnë në bankë për më shumë se 10 vjet, ndërsa vetëm 4% janë të punësuar për më pak se një vit. Grupi më i madh i pjesëmarrësve (19 %) ka punuar në finance. Nga ana tjetër, grupi më i vogël i pjesëmarrësve ishte në menaxhimin financiar dhe kredi metropolitane, me vetëm 3%.

TABELA 2. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME PËR RËNDËSINË E GJUHËS ANGLEZE NË PUNËN E PJESËMARRËSVE DHE NIVELI I AFTËSIVE NË KËTË GJUHË.

Rëndësia e gjuhës angleze në punë	Frekuenca	Përqindja
Shumë e rëndësishme	34	20
E rëndësishme	65	35
Mesatare	46	27
Pak	17	10
Shumë pak	11	8
Total	170	100%

Niveli i aftësive në gjuhën Angleze		
Fillestar	21	12
Elementar	29	17
Mirë	72	42
Shumë mirë	46	28
I përparuar	2	1
Total	170	100%

Tabela 2 paraqet rëndësinë e gjuhës angleze në punën e pjesëmarrësve dhe nivelin e aftësive në Gjuhën Angleze. Shumica (35%) mendojnë se anglishtja është e rëndësishme në punën e tyre. 27%, 10%, 20 % mendonin se gjuha angleze ishte përkatësisht mesatarisht e rëndësishme, pak, dhe shumë e rëndësishme. Vetëm 8% e konsiderojnë gjuhën angleze si pak të rëndësishme në punën e tyre. Për sa i përket aftësive, një pjesë e mirë e stafit (42 %) mendonin se niveli i tyre në anglisht është i mirë dhe 17% mendonin se niveli i tyre anglisht ishte elementar . Vetëm një prej tyre mendonte se ishte i avancuar.

Domosdoshmëria e aftësive në gjuhën Angleze

Në këtë seksion përshkruhen mendimet e pjesëmarrësve rreth domosdoshmërisë së aftësive në gjuhën angleze. Vlerësimet janë bërë në shkallën Likert me 4 pike.

TABELA 3. OPINIONET I PJESËMARRËSVE NË LIDHJE ME DOMOSDOSHMËRINË E AFTËSIVE NË GJUHËN ANGLEZE

Domosdoshmëria e aftësive të gjuhës angleze		
Aftësitë e gjuhës	Mesatarja	Vlerësimi
Dëgjimi	3.12	Nevojshme
Te folurit	3.89	Nevojshme
Leximi	3.06	Nevojshme
Shkrimi	3.10	Nevojshme
Bashkëveprimi	3.22	Nevojshme

Siç tregohet në Tabelën 3, gjuha angleze konsiderohet si e nevojshme nga të gjithë të intervistuarit. Të gjitha aftësitë janë të nevojshme veçanërisht të folurit me një mesatare 3.89, dëgjimi me një mesatare prej 3,12. leximi ka mesataren më të ulët 3.6, por ai ishte gjithashtu konsiderohet si i nevojshëm.

Opinionet e pjesëmarrësve në lidhje me vështirësitë e gjuhës angleze sipas aftësive

TABELA 4. VËSHTIRËSIA E GJUHËS ANGLEZE

Aftësitë e gjuhës	Mesatarja	Vlerësimi
Dëgjimi	3.33	vështirë
Te folurit	3.62	vështirë
Leximi	2.06	pak vështirë
Shkrimi	2.10	pak vështirë
Bashkëveprimi	3.11	vështirë

Tabela 4 tregon se të intervistuarit i konsiderojnë aftësitë e gjuhës angleze si te vështira . Vetëm leximi dhe shkrimi janë perceptuar si pak te vështira, ndërsa pjesa tjetër e aftësive u vlerësuan si të vështira.

TABELA 5: NEVOJAT E PJESËMARRËSVE RRETH AFTËSIVE TË DËGJUARIT NË GJUHËN ANGLEZE

Nevojat për dëgjim	Mesatarja	Vlerësimi
Ndjekja e prezantimeve, leksione ose biseda	2.43	Mesatare
Të ndjekë udhëzime	2.24	Mesatare
Të ndjekë shpjegime dhe përshkrime	3.14	Mesatare
Të ndjekë trajnime	3.84	Mesatare

Rezultatet e paraqitura në tabelën 5 sugjerojnë se nevoja e pjesëmarrësve për aftësitë e të dëgjuarit është mesatar, seksione i ndjekjeve të trajnimit u konsiderua më i nevojshëm me mesataren më të lartë (3,84).

Të folurit

TABELA 6. NEVOJAT E PJESËMARRËSVE PËR AFTËSINË E TË FOLURIT NË GJUHËN ANGLEZE

Nevojat e të folurit	Mesatarja	Vlerësimi
Bërja e një prezantim zyrtar	2.34	Mesatare
Bërja e një prezantim jozyrtar	2.10	Mesatare
Dhënia e udhëzime ose demonstrimit te një detyrë	2.26	Mesatare
Bërja e përshkrimeve dhe shpjegimeve	4.23	Shumë e nevojshme

Tabela 6 ilustron nevojat e te folurit ne gjuhen angleze. Siç mund të shihet, punonjësit e bankave I konsiderojnë mesatarisht te nevojshme aftësitë e të folurit ne gjuhen angleze. Megjithatë, nevoja për të bere përshkrime dhe dhënë shpjegime (= 4,2) duket se është përzgjedhur më shumë nga te anketuarit.

Leximi

TABELA 7. NEVOJAT PËR LEXIM TË TË INTERVISTUARVE

Nevojat për lexim	Mesatarja	Vlerësimi
Leximi për detaje në e-mail, letra, fakse, memorandumë, dhe raporte të shkurtra	3.32	Mesatare
Leximi shpejt për informacione të përgjithshme në revista profesionale dhe teksteve	3.10	Mesatare
Analiza për pika të veçanta në raportet e gjata, kontratat dhe dokumente, manuale për specifikime teknike.	3.05	Mesatare

Nga të dhënat mund të vërehet se veprimtaritë e listuara nën aftësitë e leximit të cilat përbëhen nga leximi për detaje në e-maile, letra, fakse, memorandumë, dhe raporte të shkurtra (= 3,32); lexim shpejt për informacione të përgjithshme në revista profesionale dhe teksteve (= 3.10); si edhe analiza për pika të veçanta në raporte të gjata, kontrata dhe dokumente, specifikime teknike dhe manuale ishin mesatarisht të nevojshme.

Shkrimi

TABELA 8. NEVOJAT E TË INTERVISTUARVE PËR SHKRIM NË GJUHËN ANGLEZE

Nevojat për shkrim	Mesatarja	Vlerësimi
Shkrimi i e-mail-ve	3.43	Mesatare
Shkrimi i letrave dhe fakseve	2.90	Mesatare
Shkrimi i raporteve dhe artikujve të gjatë	2.87	Mesatare
Redaktimi i letrave ose i raporteve të tjerëve	2.59	E ulët

Ashtu siç vihet re nga Tabela 8, nevojat për aftësinë e të shkruarit janë konsideruar nga stafit si mesatare. Shkrimi e-mail-ve është konsideruar me mesataren më të lartë (= 3,43). Shkrimi i letrave dhe fakseve si edhe shkrimit të raporteve dhe artikujve të gjata janë vlerësuar me vlera pak më të ndryshme por përsëri vërtiten rreth mesatares 2,90 dhe 2,87 respektivisht. Redaktimi i letrave ose i raporteve e të tjerëve është e vetmja aftësi e renditur si pak të nevojshme (= 2,59)

Ndërveprimi

TABELA 9. NEVOJAT E PUNONJËSVE PËR NDËRVEPRIM NË GJUHËN ANGLEZE

Nevojat për ndërveprim	Mesatarja	Vlerësimi
Pritja e vizitorëve	2.91	Mesatare
Vizita në një kompani	2.77	Mesatare
Pjesëmarrja në diskutime dhe takime informale	2.50	Mesatare
Pjesëmarrja në takime formale	2.54	Mesatare
Kryesimi i takimeve	1.71	E ulët
Intervistimi	1.40	E ulët
Negocimi	1.67	E ulët
Kryerja e telefonatave	3.21	Mesatare

Tabela 9 tregon nevojat për ndërveprim në gjuhën angleze. Duke marrë parasysh që funksionet bashkëveprojnë, pesë funksione duke përfshirë të telefonuarit (= 3,21), vizita në kompani (= 2,77), pritja e vizitorëve (= 2,77), marrja pjesë në Ditët e Studimeve Shqiptare / 2015

diskutime dhe takime joformale (= 2,50), dhe takime formale (= 2,54) janë konsideruar si të mesatarisht të nevojshme. Nga ana tjetër, intervistimi (= 1,40), negociimi (= 1,67), dhe kryesimi i takimeve (= 1,71) u vlerësua si një nevojë e ulët.

Problemet në përdorimin e aftësive të dëgjimit në gjuhën angleze

Kjo pjesë e rezultateve të pyetësorit i përgjigjet pyetjes së dytë të kërkimit: Çfarë problemesh hasin punonjësit e bankave në përdorimin e gjuhës angleze? Pyetjet janë të ndara në pesë fusha kryesore të aftësive gjuhësore: dëgjimi, të folurit, leximi, shkrimi, si edhe ndërveprimi.

Dëgjimi

TABELA 10

Problemet në dëgjim	Mesatarja	Vlerësimi
Ndjekja e prezantimeve, leksione ose biseda	3.34	Mesatare
Të ndjekë udhëzime	2.44	Mesatare
Të ndjekë shpjegime dhe përshkrime	3.21	Mesatare
Të ndjekë trajnime	3.75	Mesatare

Tabela 10 tregon se problemet më të dëgjuar në gjuhën angleze janë konsideruar si mesatare. Mesatarja e katër aftësive që janë ndjekja e prezantimeve, leksioneve ose bisedave (= 3,34), të ndjekë udhëzime (= 2,44), të ndjekë përshkrime dhe shpjegime (= 3,21), si edhe të ndjekë trajnime vijim (= 3,61) janë në të njëjtën shkallë vlerësimi.

Të folurit

TABELA 11. PROBLEME NË PËRDORIMIN E TË FOLURIT NË GJUHËN ANGLEZE

Probleme të të folurit	Mesatarja	Vlerësimi
Bërja e një prezantimi zyrtar	4.10	Shumë
Bërja e një prezantimi jozyrtar	3.35	Mesatare
Dhënia e udhëzimeve ose demonstrimit të një detyrë	3.26	Mesatare
Dhënia përshkrimit dhe shpjegimit	3.23	Mesatare

Tabela 11 paraqet problemet e hasura nga punonjësit kur përdorin aftësinë e të folurit në gjuhën angleze. Pjesëmarrësit i konsideruan vështirësitë e përdorimit të aftësive të gjuhës angleze dhe të folurit si mesatare. Prezantim formal u konsiderua si shumë problematik me vlerësimin më të lartë (= 4,10).

Leximi

TABELA 12. PROBLEME NË PËRDORIMIN E TË LEXUARIT NË GJUHËN ANGLEZE

Nevojat për lexim	Mesatarja	Vlerësimi
Leximi për detaje në e-mail, letra, fakse, memorandume, dhe raporte të shkurtra	4.32	Shumë
Leximi shpejt për informacione të përgjithshme në revista profesionale dhe teksteve	3.23	Mesatare
Analiza për pika të veçanta në raportet e gjata, kontratat dhe dokumente ligjore, manuale për specifikime teknike.	4.19	Shumë

Sipas Tabelës 12, mund të shihet se punonjësit kanë shumë probleme në leximin për detaje në e-mail, letra, memorandume, dhe raporte të shkurtra fakse si edhe aftësia e leximit për analizë në raportet e gjata, kontratat dhe dokumentet ligjore, si dhe specifikimet teknike duke u konsideruar si shumë problematike (= 4,32), (4.19). Leximi shpejt i revistave profesionale dhe teksteve shkollore për informacione të përgjithshme ishte mesatarisht e vështirë

Shkrimi

TABELA 13: PROBLEME NË PËRDORIMIN E TE SHKRUARIT NE GJUHEN ANGLEZE

Nevojat për shkrim	Mesatarja	Vlerësimi
Shkrimi i e-mail-ve	3.23	Mesatare
Shkrimi i letrave dhe fakseve	3.42	Mesatare
Shkrimi i raporteve dhe artikujve të gjatë	3.26	Mesatare
Redaktimi i letrave ose i raporteve të të tjerëve	3.49	Mesatare

Nga Tabela 13, duket se punonjësit e bankave kanë cilësuar me vështirësi mesatare të gjitha kategoritë nën aftësinë e shkrimit në gjuhën angleze.

Ndërveprimi

TABELA 14. PROBLEMET E PUNONJËSVE NË NDËRVEPRIM NË GJUHËN ANGLEZE

Nevojat për ndërveprim	Mesatarja	Vlerësimi
Pritja e vizitorëve	3.72	Shumë
Vizita në një kompani	2.81	Mesatare
Pjesëmarrja në diskutime dhe takime informale	3.15	Mesatare
Pjesëmarrja në takime formale	2.74	Mesatare
Kryesimi i takimeve	3.29	Mesatare
Intervistimi	3.41	Mesatare
Negocimi	2.67	Mesatare
Kryerja e telefonatave	4.21	Shumë

Tabela 14 tregon vështirësitë në përdorimin e gjuhës angleze lidhur aftësitë e ndërveprimit. Mesatarja nënkupton që punonjësit kanë vështirësi mesatare në përdorimin e aftësive të ndërveprojnë në anglisht. Vetëm pritja e vizitorëve (= 3,72) dhe kryerja e telefonatave (= 4,21) janë konsideruar si shumë të vështira ndërsa pjesa tjetër e aftësive u perceptuan si mesatarisht të vështira.

Konkluzione/ Rekomandime

Analiza statistikore e të dhënave të mbledhura përmes pyetësorit siguroi të dhëna të cilat mund të përdoren për t'iu përgjigjur pyetjeve të kërkimit:

Në çfarë shkalle është nevoja e përdorimit të gjuhës angleze nga punonjësit e bankave?
Cilat janë problemet në përdorimin e gjuhës angleze që hasin punonjësit gjatë punës?

Nga studimi i pyetësorëve, u arrit në përfundimin se pjesëmarrësit e perceptojnë gjuhën angleze si të nevojshme në punën e tyre. Ata gjithashtu deklaruan se gjuha angleze po bëhet një temë gjithmonë e më të rëndësishme në punën e tyre meqenëse banka ka për qëllim të ofrojë shërbimet më të mira dhe cilësore për klientët e saj për të qenë një konkurrent kryesor në mjedisin me zhvillim të shpejtë të biznesit. Shumica e punonjësve i konsiderojnë aftësi e tyre në gjuhën angleze në nivelin elementar dhe si rrjedhojë mendojnë se kanë nevojë për të përmirësuar aftësitë e tyre në gjuhën angleze në mënyrë që të përmbushin objektivat e biznesit bankar. Nga rezultatet e studimit, më thelbësore ishte aftësia e të folurit në gjuhën angleze,

ndjekur nga të dëgjuarit. Bashkëveprojmë dhe shkrimi ishin njëloj perceptuar si aftësitë e ardhshme të nevojshme. Kurse të lexuarit u konsiderua si më pak të nevojshme.

Meqenëse gjetjet e këtij studimi ofrojnë një pasqyrim të qartë të nevojave dhe problemeve të të punësuarve në banka, ato mund të jenë të dobishme për përgjegjësit e politikave të trajnimit të planifikimit. Rezultatet mund të sigurojnë udhëzimet për të hartuar, rishikuar ose dhe zhvilluar kurse efektive dhe efikase të Anglishtes për Qëllime Biznesi dhe materiale për stafin. Një plan mësimor dhe materiale të prodhuara posaçërisht për punonjësit dhe të përshtatura për nevojat e tyre do të rezultonte në një përmirësim të aftësive të tyre në gjuhën Angleze dhe do të bënte të mundur atyre që punonjësit të përdorin gjuhën në mënyrë efikase në punë.

Bibliografia

- Bhatia, V. K., & Candlin, C. N. (1998). The law society of Hong Kong project: strategies and competence in legal communication – a study to investigate the communicative needs of legal professionals. Hong Kong: City University of Hong Kong.
- Carnevale, A. P., Gainer, L. J., & Meltzer, A. S. (1990). Workplace basics: the essential skills employers want. San Francisco: Jossey-Bass Publishers.
- Chew, K.-S. (1999). Multiple discourses in business education: occupational perspective – the interface between the academy and the business world. Paper presented at the 12th World Congress of Applied Linguistics (AILA99, August, Tokyo).
- Chew, K.-S. (2000). Money talks: an investigation into the professional discourse of employees in the Corporate Communications Department of a medium-sized bank in Hong Kong. Unpublished rawdata of Thesis, University of York, England.
- Evans, S. (1999). Workplace communication in a time of transition: the case of Hong Kong's construction industry. *Hong Kong Journal of Applied Linguistics*, 4(2), 57–78.
- Firth, Alan and Johannes Wagner (1997). On discourse, communication, and (some) fundamental concepts in SLA research. *Modern Language Journal* 81: 285–300
- Green, C., & Evans, S. (2000). A survey of language use in the professional workplace in Hong Kong.
- Hutchinson, T. and Waters, A. (1987). *English for Specific Purposes: A learning-centred approach*. Cambridge: Cambridge University Press
- McCrum, R. (2010) *GLOBISH: How the English Language Became the World's Language*
- Munby, John. 1978. *Communicative syllabus design*. Cambridge: Cambridge University Press
- Richterich R. and Chancerel J-L. 1980. *Identifying the Needs of Adults Learning a Foreign Language*. Oxford: Pergamon Press.
- Robinson, P. 1991. *ESP Today: A Practitioner's Guide*. London: Prentice Hall
- Stevens, P. 1980. *Teaching English as an International Language: From practice to principle*. Oxford: Pergamon Press
- Trochim, W. M. 2006. *Research Methods Knowledge Base (Online)*. <http://www.socialresearchmethods.net/kb/>, April 28, 2007.
- Widdowson, H.G. 1983. *Learning Purpose and Language Use*. Oxford: Oxford University Press.

THE PRESENCE OF ALBANIAN WOMEN IN POLITICS; AN EMPIRICAL INVESTIGATION

DILINA BESHIRI, PH.D

University "A. Moisiu" Durrës, Faculty of Education, Pedagogy

E-mail: dilina_b@hotmail.com

ASSOC. PROF. DR. EDI PUKA

European University of Tirana, Faculty of Social Sciences and Education,

Pedagogy E-mail: edi.puka@uet.edu.al

ABSTRACT

This article is the result of a research work on the relationship between education and politics, developed in view of literature, studies and research in sociology and political sciences. It will try to reconstruct a profile of women's emancipation and participation in politics. The historical background is important to understand the differences in representation of women in politics, while crucial are also the factors leading to this disparity. On the one hand is supported the quantitative aspect of an equality in the presence of women, while on the other is brought its qualitative dimension. The process of the exposed research is focused on the active, effective and conscious presence of women in society, referring specifically to what constitutes their commitment in political contexts, meaning by the latter political parties as well as associations of a social interest. Talking about the relationship between women and politics allows one to analyze from a certain point of view the involvement of women within the society, taking into analysis those forms of activation concerning interests falling outside the subjectivity and get settled on needs, necessities, wishes that include a collective or intersubjective sphere.

In addition to these objectives, the research on the presence in politics of women in Albania has allowed us to look at the attitude of women in politics from a different perspective compared to earlier researches. It is a qualitative view, that is what passes first through a methodology and then a method that, although renouncing an epistemological rigor, employs not only interviews and statistical analysis, but while giving importance to them as a starting point, deepens the field analysis by talking directly to involved subjects, dealing with their motivations and experiences, giving relevance to the story they provide as privileged witnesses of a process and a context to which they belong.

Keywords: *women; education; policy; training; participation*

1. Introduction

Talking about the role of Albanian women in politics leads us to think around some decisive issues, which have influenced the emancipation and advancement of women not only in the country's political life, but also in the social, cultural and economic one. Having a deep understanding of political culture is undoubtedly useful to refer to the crucial periods for Albanian women. Although the intervention of the Albanian Government, which aims to bridge the inequality between genders by different laws (such as rose quota), the presence of strong and deep rooted patriarchal traditions has led to a new process of marginalization of women in economic, social and political life of the country. The debate on quotas, however, was very strong, especially in recent years, both in public opinion and at institutional level. Making a comparison with other European countries where the quota mechanism is widespread, we can identify interpretative hypotheses useful to reflect on the model adopted by the Albanian government. The quota system can be considered as a first step, but to be more efficient, it must be accompanied by other types of initiatives. Without a more complex operation right on the cultural level, the interventions of rose quotas are likely to be a further element of distortion falling within the more general framework of negative judgment deserved by the system of lists compilation at national level.

A greater number of women in politics can be the ingredient of a transformation of the objectives of policy itself also. No doubt, the proposed solutions are far from being consensual, and in fact far from being considered feminist. But it is certain that the feminization of political elites represents a cultural and social change that cannot be reduced simply to the balance of political representation between men and women, but also to the recognition (and transformation) of social and gender relations in an area, where politics has always been the prerogative of male world. The relative subject on women's political participation has achieved recently a strong actuality. The European Union has taken a number of initiatives, involving the individual national governments. Although women in the last century have acquired political rights, they have not been able to join in a substantial measure representative political institutions. This phenomenon involves all countries of the world without any distinction. In Albania also women are *missing* in the political scene both in terms of representation in decision-making settings, as well as in terms of participation in political life in its broadest sense.

2. Methodology

On basis of theoretical considerations and study references, it was intended to conduct a qualitative research on the Albanian women's political participation and their political attitudes and behaviors.

The purpose of this article will be that of carrying out a survey concerning the reasons of women's low participation in various levels of government and in the Albanian political world. The first phase of research will be dedicated to the collection of necessary documents and information for the reconstruction of stages and highlighting the most important data around which is developed the Albanian women's political action. On the one hand will be emphasized the quantitative aspect of an equal presence of women, while on the other hand will be regarded the qualitative dimension. This first phase will be followed by an analysis of data and statistics on the issue of political participation of Albanian women. Finally, it is intended to comprehend the complex phenomenon of relationship between women and politics through a series of structured interviews. The interviews were aimed at representative women holding active roles in the Albanian political world and at "represented women". (Carrera & Persichella 2010: 26-27)

The interviews were conducted in the cities of Tirana and Durrës, addressed to a total sample of 46 women, aged between 18 and 60 years, randomly selected to represent the different types of political participation.

It was decided to apply the technique "of half-directive interview"¹, (Crespi & Mucchi Faina 1988: 13-27), in order to guarantee to the interviewed person a large degree of freedom in setting up the discourse and hypotheses that one can move forward.

3. The explanatory factors of the poor representation of women in political life

"The under-representation of women in institutions is a clear sign of the failure to resolve old problems, but also of a more general socio-cultural and economic crisis that involves *in primis* the political representation." (Raniolo 2008)

This crisis is expressed generally by requiring more and better reflection of the actual conditions of life in the political arena. The crisis of traditional political representation is combined, therefore, with new demands for social representation of inclusive kind, since the general interests of the country and in particular those of gender seem no longer to be able neither to find an adequate expression, nor to have the ability to influence the political agenda.

In Albania, despite frequent planned statements and intents of political parties, women are struggling to make their way in politics and this is a clear sign of a general crisis of political representation, which is usually expressed by requiring a greater and better reflection, i.e. sociological representation of the facts of reality. The demand for a greater presence and a more adequate representation of women in politics is in fact indicative of a social "emergency". Therefore ascertaining and settling

The half-directive interview is intended to deepen a specific topic on basis of a trail that is retrieved only when the respondent does not address spontaneously the concerning issues.

¹"Transformimi i Madh: 25 vjet përvoja shqiptare e tranzicionit dhe demokratizimit"

for just “how many” women are present in the institutions would be a simplistic solution in itself, since it is instead necessary to specify in what terms a more substantial presence of women in politics can make a difference and give precedence to a different planning policy.

It appears useful to trace the factors that can influence the quality and quantity, but also the forms of lack of women presence in Albanian politics, emerged from the interviews analysis. And, as we shall see afterwards, different opinions emerge on the attitudes, values and behaviors of respondents, about the lack of female representation. On one hand are revealed historical-cultural factors (the macho culture), on the other hand, the psycho-social factors (self-exclusion of women).

3.1 The macho mentality in politics

There are plenty of women affirming that the macho mentality of the Albanian politics and society still manages to stop the implementation and application of the right of women to decide in the same way as men do.

“The Albanian society is a male-dominated society, just as politics, and for this reason I have not even thought about participating”; (Sample: student, worker, housewife, graduate)

- “I wanted to participate in politics, but they do not allow us to take part. The Albanian politics is “miserable” and sexist.” (physician)

The investment in Albanian politics is rarely considered as an opportunity for women in Albania. This mentality, very often, is recorded in the social life of women and has created on the one hand the foundation for cultivation of a deformed socio-cultural model, which recognizes as normal the status of marginalization of women in political participation and on the other hand the cultivation of other mechanisms of career that are deeply cooptative. The power is homophile, meaning that it promotes those equal to themselves. That is when there is a political reality, in which there are no precise rules, the selection mechanisms are fatally cooptative. The one who has the power, accepts those equal to himself. That’s why for twenty years, the Albanian politics is considered a “job” for men only, as the woman, because of her fragile nature, cannot participate.

“Unfortunately, the Albanian politics is the domain of males”; (teacher)

“I do not want to participate in politics, because Albanian male politicians are dominating politics more and more.”

(sample: teachers, workers)

The manner in which politics in Albania is conceived, designed and carried out, is also a result of total lack of civic sense, brutality, offenses etc.; which become a serious barrier to consider politics as a natural, social and appropriate for women. This is due both to factors deeply rooted in Albanian culture, attributable to the representation of female figure often portrayed as a weak subject and in need of protection, as well as to more markedly political factors, strongly reflected on the permanence of many problems caused by the difficult reconciliation of women’s roles at work, family and politics itself.

In this context, the policy has its own responsibilities for the low level of women’s participation in the parliament and beyond. This reality produces also an effect of no confidence that women feel towards their own potential, which leads to self-exclusion.

3.2 The self-exclusion of women

The women interviewed (the majority) report a sort of weakness of the historical significance of women’s exclusion. On this perspective, women have to contend with the heavy legacy of the past that did not allow them to gain the necessary experience to participate in the political world. A political commitment to women in particular is likely to become the third role, after family and work, thus making it very difficult for women to be present in the world of politics.

One of the additional mechanisms that one can assume, in some cases, is that of a real lack of confidence on the part of women themselves to politics.

“The policy has disappointed me a lot. I participated actively in politics for several years and then I retired. I was part of the Democratic Party, where, however, I saw that there was lack of democracy, autonomy and freedom of thought.” (university lecturer)

“I participated in the social and political life, but it was very difficult to participate fully, because the representatives of the Albanian politics do not allow speaking up and exercising the own rights. I can also say that the most important factor of low representation of women in politics is the lack of a culture and tradition of doing politics, and this not only among women.” (teacher)

“The under-representation of women in politics, in addition to being the result of discriminatory action, is also linked to some difficulties they experience in performing their political career, and that leads to their self-exclusion.” (Pojaghi 2010: 164)

But why do women exclude themselves?

The under-representation of women in politics, in general, seems to be attributed also to the tasks of care to the family,

especially to the children, “as confirmed by recent surveys” (ISTAT: 2010), that still fall mostly on women and do not allow them an easy access to the world of political representation, especially if they’re accompanied by professional commitments at work. In addition, the election campaign requires a great commitment outside home, a commitment that the family burden on a woman does not always allow.

“I would have liked to participate in politics, but the family conditions and commitment to my children will not let me.”
(housewife)

“Women do not participate, because they have no time for politics.” (Sample of working women and housewives)

Women have a very strong sense of politics. The majority of them believes it to be driven by a civic duty, that politics is a duty for which one should be well prepared and that politics, beside being structured for men, is nevertheless compatible with the women’s life.

A problem reported especially by women possessing a good educational level is that they have the ability to act fully in politics, but they feel on their shoulders the weight of a traditional foreclosure.

“I always had the desire to participate actively in politics, but for lack of time and perhaps a lack of tradition in politics, I have never been able to be a part.”; (student)

“I was not invited to join any political party or to participate.” (worker)

The interviews show clearly also the lack of a political culture and tradition. This is linked also to consequences of recent and imperfect democracy, where the imperfectness is due to the combination of political, economic and cultural factors, and the discrepancy between the active sectors of society and the power system.

The fact that only a few women are elected, is related to the fact that in the Albanian culture is still strong the image of male politician as a “model role”, while a model of political leadership for women has not yet been created. In fact, this political reality prevents women from participating actively. Currently women who want to succeed in politics ought to adopt the model of rude and loud male. A model, however, which bears no resemblance to what they wish to be. Because it conflicts with their feeling as a woman. This is another psychological barrier, for those feel themselves women, to become part of this political context.

Another aspect to be highlighted is the generation gap: right among the under 30, in fact, there appears a lack of that enthusiasm that should instead characterize the new generations. The main motivation of politics is linked to the effect of disappointment, but among the first ones persists, with some relevance, the loss of interest.

“I have no interest in politics. Albanian male politicians are giving an increasingly negative image of the way of doing politics”; (degree in psychology, 25 years old)

“I do not care to participate in politics, but even if I did, it is almost impossible for a woman to participate in the Albanian “masculine” politics without being manipulated by men.” (secretary, 21 years old)

“I am very disappointed by politics. We see that our politicians care more and more for themselves, and not for the good of citizen and the country.” (hairstresser, 29 years old)

“On the one hand, female political participation depends to a large majority of the representations that subjects have about state and politics, and those representations get fed on the path of political socialization experienced by each of the images conveyed to the same subjects by the political information in a broad sense.” (Carrera 2010: 178)

On the other hand, presence of women in politics brings that entirely personal approach, typical of the female world, purely programmatic, as it is known that women are very concrete in the management of “res publica” and determined to achieve the objectives they pursue, and certainly less accustomed than men in the frantic search for positions of power, as well as the use of the latter for purely personal gratification.

Although recognized as citizens, Albanian women are now to demand rights already obtained, starting from the socio-economic ones, jeopardized by the economic crisis and devalued because of new political pacts that exclude them from both public as well as private “business”. And the danger is now so evident the more visible becomes an increasing permeability and contiguity between business world and representative bodies. A small proportion of women show a bleak picture of the status of women in Albania.

“Politics does not give one the opportunity to be part of. Today, the majority of women are unemployed and this leads to their lack of interest to participate actively in politics”; (small entrepreneur)

“Most of the Albanian women are unemployed. First of all women should have an employment contract, and then we can talk about political participation.” (Under contract)

As reflected in the interviews, poverty predominantly affects women not only because they bear the burden of the effects of unemployment, but also because of discrimination in terms of wages compared to men.

4. Attitudes, values and behaviors of privileged witnesses

By the indices reported by the *Global Gender Gap Report* (2012), the comparisons between Albania and other countries are remarkable, as Albania can certainly not be regarded as an equitable society, especially due to the growing gap between men and women in terms of unemployment, as well as of employment discrepancy on top positions. Such a crisis is expressed generally by a larger request and a better reflection of the actual conditions of life in the political arena, or a type of “sociological” representation to describe the true status of a given society.

“Historically, the political arena has always been under the domination of men, not only in Albania, but throughout the world. The history is a story of men power, but in the last century in Albania there is a growing women’s movement to participate in politics. This is a natural fact knowing that human society is divided equally between males and females. It is a historical injustice that due to many factors, such as cultural and social prejudice and attitudes, women have never been part of the political power, which has always been dominated by men.” (political activist D. Çuli).

For several decades, it was a rare thing to see a female in leadership of the Albanian politics, for they were men who dominated, but it seems that this mentality is changing.

We can mention here the former President of the Albanian Parliament, Jozefina Topalli, as the first woman in the history of Albania having held this role. Jozefina Topalli Coha became a president in September 2005 after serving as Vice President of the Albanian Parliament in the two previous legislatures (1997-2001, 2001-2005). She, like the majority of women currently involved in Albanian politics, has a past as a university lecturer.

The question arising is why these women have decided to “abandon” their profession and to become a part of politics?

The Honourable Member Topalli answers:

“It may seem strange, but it happens to make decisions without necessarily wishing them. It was the year 1996, as the Democratic Party was looking for a greater representation of women in politics. At that time I was working as a lecturer at the University of Shkodra. I felt professionally realized and I had big dreams for my future. When I was asked to run for deputy in the Albanian parliament, at the beginning it seemed strange to me and I refused. They were my friends who convinced me. To them I responded with a determined “Yes”.”

Despite the remarkable increasing of women’s representation in the parliament, this is still not to be noted in the government.

“It is true that ours is a men-dominated society, which does not allow you to easily join the political world, and especially in senior positions, but also women themselves are uninterested in politics.” (Honorable Member J. Topalli)

In the Albanian government, as seen in Table 1, there is only one woman in a ministerial position, Mrs. Majlinda Bregu, Minister of Integration, since March of 2007, for a second term.

TABLE 1 - THE PARTICIPATION OF WOMEN IN GOVERNMENT DURING THE PAST LEGISLATURES

Legislature	2005-2009		2009-2013	
	Men	Women	Men	Women
Prime Minister	1	0	1	0
Deputy Prime Minister	1	0	1	0
Ministers	17	1	14	1
Deputy Ministers	15	6	28	6

Source: Women and Men 2005, Tirana 2006; Women and Men 2009, Tirana 2010;

In the meantime, there is an entirely new phenomenon; many more women do not come from a political activity. We can mention Vasilika Hysi, former head of the Albanian Committee of Helsinki, parliamentarians such as Rajmonda Bulku and Luiza Xhuvani, both actresses, or Rudina Seseri and Albana Vokshi, who have never been occupied earlier with politics.

The Honourable Bulku, one of the most famous faces of the Albanian cinema, decided to participate in politics:

“I have always been a supporter of the movement for the fall of the communist regime. At that time I was still very young and I had many projects in regard of my profession and family. Now that the family circumstances allow me, I decided to enter politics. In fact, I decided this also after to many requests made by the Democratic Party to increase the proportion of women in the parliament.”

By the behavior of privileged witnesses, it is noted that, rather than their own desire to participate actively in politics, it was by the will or request of politicians that, in order to achieve their goals to increase quotas for women in the parliament, they have “convinced” women to join the Albanian political life.

In fact, this form of representation, just to increase the percentage of women in Parliament, is a substitute for political representation. The “mere (physical) presence” of women in politics does not exhaust the problem of representation. That should make us reflect on what it is misleading to treat the problem of women representation as merely a “quantitative” one or, worse, as a simple “formal” determination related to quantity and not quality of democratic representation, although it is important to support the principle of equality.

Crucial to emphasize is the demand for more qualitative presence of women in politics, as well as a quantitative representation, which is indicative of a political, economic and cultural “emergency” for the Albanian society, and it must be addressed as such.

Even if:

“For a woman it is much more difficult to participate in politics, because women have much more important commitments, such as children, home, and they have also a key role with regard to the basis of society, the family. It is equally important to note that woman in Albania undergoes very often verbal the violence of male-dominated society.” (Honorable Member M. Kodheli)

“I believe that politics in Albania is degenerating into a policy of mutual offenses. It is a policy poor of topics and opportunities for the future. The rude and brutal language used, in my opinion, harms not only people to whom it is addressed, but also the entire Albanian society as a whole.” (Honorable Member V. Leskaj)

Results

The factors of poor political participation are multiple, many of the testimonies heard from represented or representing women show mainly two types of problems:

The role of obstructionist men hindering women’s desire for leadership and participation is highlighted. This interpretation is especially relevant by women who participate as totally distant citizens and women, which clearly allocate to this factor the low presence of women in politics.

b) The lack of confidence in Albanian politics. Trust in political institutions is considered by many an indicator of the health of democracy. In Albania, the trust appears with varying intensity depending on the subject or institution considered: it is certainly high for the family, significant for the institutions and low for the protagonists of politics and political parties in the first place.

It seems appropriate to point out that much less popular are the remaining hypothesized reasons for the low participation of women in politics, namely that: women are not brought to politics; an alleged handicap of women in politics related to the special role played by women in the Albanian society; also very few women, especially those “in career”, blame the temporary deficit handicap as an obstacle to participate in politics.

In order to facilitate the participation of women in the political sphere, or to facilitate the entry of women in fields that for a long time were male prerogative, there are two main strategies: policies for equal opportunities and policies of affirmative action. The first is the commitment on the part of political leaders to promote a system of political representation, recognizing the equal opportunities between men and women, without legal implications. The positive actions, however, represent the most significant strategy to encourage the participation of women.

6. Conclusions

The problem of women representation is, therefore, a crucial issue to be addressed, because it calls into question the founding principles of civilized life. Women, although they were the protagonists of the most significant processes of social transformation in the last decades of the history of Albania, still have no access to or actual weight in that part of public life which decides and controls the future of society. The lack of women in political life signals also a disconnection between political and civil society, where women have taken on a growing role.

The issues of representation and political participation of women in Albanian politics must deal with a series of nodes and issues: first, the fact is that, as it emerges also from the interviews conducted for this study, most of experiences of consultation or representation proposals to women in different contexts have guaranteed to the elected women neither a representation, nor a greater progression in the acquisition of political rights.

Creating the conditions for increasing the number of women in decision-making issues is also and above all a task that women must carry in person, through a full and conscious confidence in their abilities, even if in logic and methods of political representation there are some other obstacles that make more difficult the access of women in institutions.

The reasons for this phenomenon are various and linked both to crisis of representation, as well as to socio-cultural factors. One of these is also the type of majoritarian electoral system, which in itself tends to exclude minor political forces and young people who today are on the margins of politics. In the basic structures of political parties and trade unions, as the women are not present to a considerable extent, has not been created a political movement for women, able to establish itself as a point of reference for electing and elected persons.

The asymmetry of power at political level becomes thus a symbolic marker, which makes evident the lacking process of fairness and equality between sexes. There must be a sensitization of public opinion on this issue, and a change of a political culture that, even today in Albania, considers man the legitimate protagonist of the state management. In addition, we need concrete measures to promote women's political participation, because all those social and political systems in which women are under-represented are to be considered as democratically "uncompleted".

References

- Carrera, L. & Persichella, E., (2010). "Le Donne Distanti. Tempi, Luoghi, Modi della Partecipazione Politica", Bari: Progedit, pp. 26-27.
- Carrera, L., (2010). "Modi e Luoghi di Partecipazione. E uno Sguardo Particolare alle Donne", in Carrera, L., (ed), Fare o Non Fare Politica. Soggetti, Modi e Luoghi, DFEP, (IV), Milano, Guerini Scientifica, p.178.
- Crespi, F. - Mucchi Faina, A., (1988). "Le strategie delle minoranze attive. Una ricerca empirica sul movimento delle donne", Napoli, Liguori, pp. 13-27.
- Istituto Nazionale di Statistica, (2010). "La divisione dei ruoli nelle coppie". (<http://www.istat.it/salastampa/comunicati/non.../testointegrale20101110.pdf>)
- Pojaghi, B., (2010). "Donne e Partecipazione Politica", in Comitato Pari Opportunità, Etiche e Politiche di Genere, Bari, Servizio Editoriale Universitario, p. 164.
- Raniolo, F., (2008). "La partecipazione politica", Bologna, Il Mulino.
- World Economic Forum, (2012). "Global Gender Gap Report". (<http://www.ipu.org/wmn-e/classif.htm>) Last seen 04/06/2014

SISTEMI MEDIATIK SHQIPTAR DHE ROLI I TIJ NË KONSOLIDIMIN E DEMOKRACISË

LORENA LIÇENJI

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale
lorena.licenji@uet.edu.al

ABSTRAKT

Ky punim synon të analizojë rolin e luajtur nga sistemi mediatik shqiptar në procesin e gjatë të tranzicionit drejt demokracisë. Studimi i paraqitur ka si qëllim të studiojw mënyrën dhe formën nëpërmjet të cilave mjetet e komunikimit masiv kanë influencuar procesin e tranzicionit politik shqiptar dhe piren të influencojnë edhe zhvillimet e ardhshme politike.

Ashtu sikurse ka ndodhur edhe në vendet e tjera ish komuniste, ato të cilat tashmë e kanë kaluar peridhën e vështire të tranzicionit drejt demokracisë, edhe në shqipëri ndryshimet rrënjësore që kanë karakterizuar sistemin mediatik mendohet të kenë luajtur një rol domethënës në procesin e gjatë të tranzicionit dhe gjithashtu mund të konsiderohen faktorë influencues në procesin e konsolidimit të demokracisë.

Ky studim synon të sjellë një analizë gjithëpërfshirëse mbi mënyrën se si media mund të influencojë jo vetëm transformimin e sistemit politik por edhe atë individual, social dhe ekonomik.

Përkujdesi i veçantë i treguar nga sistemi politik përkundrejt atij mediatik do të analizohet në dy prespektiva.

Së pari, si ndikon sistemi mediatik në mënyrën e perceptimit të sistemit politik dhe në procesin e tij transformues?

Së dyti, në çfarë mënyre mediat mund të modifikojnë sjelljen, organizimin dhe strukturimin e shoqërisë shqiptare?

Ky punim priret të analizojë, duke ju referuar kontekstit shqiptar, rolin e medias në daljen nga procesi i tranzicionit dhe në konsolidimin e demokracisë, nëpërmjet evidentimit të problemeve të hasura gjatë kësaj periudhe. Njëkohësisht synon të identifikojë aspektet karakterizuese të procesit të konsolidimit, me një vëmendje të veçantë tek faktorët që kanë ngadalësuar ecurinë e këtij procesi në shoqërinë shqiptare.

Fjalë kyç: *Media, shoqëri, politikë, demokraci, tranzicion, konsolidim*

1. Hyrje

Në fillim të shekullit të XX me përhapjen e shtypit dhe më pas edhe të radios, kinemasë dhe televizionit, mjetet e komunikimit u bënë pjesë e pandarë e shoqërive moderne perëndimore. Bashkë me përhapjen e mjeteve të komunikimit masiv lindën edhe studimet e para mbi influencën e ushtruar nga sistemi mediatik në sferën individuale dhe shoqërore.

Nëpërmjet analizës interpretuese të efekteve që mediat mund të ushtrojnë në shoqëri, vëmë re mundësinë e një prespektive të dyanshme. Së pari, sistemi mediatik, me shumëllojshmërinë e formave dhe funksioneve të tij, konsiderohet një element i rëndësishëm në formimin dhe konsolidimin e demokracive të reja. Këndvështrimi i dytë konsideron mediat si një produkt i sistemit kapitalist, dhe si pasojë një industri kulturore që ka si objekt shpërndarjen e produkteve homogjene për një publik masiv (Eco, U. 1964). Nisur nga këto dy këndvështrime konstatohet aftësinë e sistemit mediatik në përcjelljen e vlerave, orientimin e sjelljeve të audiencës dhe dhënien e një kontributi të rëndësishëm në stabilitetin e shoqërisë.

Duke ju referuar kontekstit shqiptar, për të analizuar rolin e ushtruar nga media në procesin e tranzicionit duhet së pari të reflektojmë mbi funksionin tërësisht propagandues të ushtruar nga media gjatë rregjimit komunist.

Në fillim të viteve '90, me krizën e sistemit politik, social dhe ekonomik, sistemi mediatik pësoi ndryshime rrënjësore jo vetëm në funksionimin dhe organizimin e tij, por edhe në rolin e luajtur si mjet socializimi midis individëve.

Në kontekstin shqiptar është folur shumë mbi procesin e tranzicionit, por pak studime janë përqëndruar tek roli që sistemi mediatik mund të ketë luajtur në përzgjedjen e këtij procesi.

Falë analizës historike të pluralizmit politik në Shqipëri vihet re prania e fazave të ndryshme të transformimit dhe bashkëveprimit midis sistemit mediatik dhe atij politik, bashkëveprim me impakt të rëndësishëm në procesin e tranzicionit.

Përgjatë dhjetëvjeçarit të parë të tranzicionit, lidhja ndërmjet elitës politike dhe medias ka rezultuar e paqartë dhe ambigue. Në fillim të viteve '90, si pasojë e paqëndrueshmërisë të forcave politike dhe ndërthurjes së tyre me interesat ekonomike, sistemi mediatik transformohet në një mburojë të interesave politike dhe ekonomike (Krasniqi, A. 2006). Ndërvarësia e krijuar ndërmjet sistemeve themelore të një shoqërie demokratike u reflektua edhe në vështirësitë e hasura gjatë procesit të demokratizimit. Si rrjedhojë, përgjatë viteve '90 shoqëria shqiptare ka kaluar momente të vështira dhe kontroverse të shoqëruara me humbjen e besimit në sistemet politike dhe në institucionet politikbërëse.

Por kush ishte qasja e elitës politike shqiptare ndaj sistemit mediatik?

Pavarësisht raporteve ndërkombëtare që paralajmëronin rrezikun që mund të vinte si pasojë e lidhjeve të ngushta midis interesave të klasës politike dhe sipërmarrësve të sistemit mediatik, elitat politike shqiptare treguan një interes të veçantë për ushtrimin e një kontrolli politik mbi sistemin mediatik duke krijuar me këtë të fundit një raport që shpesh herë ka marrë formën e një konvergjence të plotë midis sistemit mediatik, klasës së re politike dhe kapitalistëve të rinj (Gritti, R. 2001).

2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Ky studim synon të sjellë një analizë gjithëpërfshirëse mbi mënyrën se si media raportohet me transformimin e sistemit politik, social dhe ekonomik.

Ky punim priret të analizojë, duke ju referuar kontekstit shqiptar, rolin e medias në daljen nga procesi i tranzicionit dhe në konsolidimin e demokracisë, nëpërmjet evidentimit të problemeve të hasura gjatë kësaj periudhe.

Studimi synon:

Të analizojë kompleksitetin e tranzicionit shqiptar drejt demokracisë.

Të analizojë faktorët që kanë ngadalësuar ecurinë e këtij procesi.

Të identifikojë aspektet karakterizuese të procesit të konsolidimit.

Nëpërmjet këtij studimi do të mund të identifikojmë mënyrën nëpërmjet të cilës mjetet e komunikimit influencojnë procesin e tranzicionit por edhe raportin e krijuar ndërmjet sistemit politik dhe sektorit ekonomik gjatë ecurisë së këtij procesi.

3. Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Pyetja kërkimore në qendër të këtij studimi fokusohet në identifikimin e faktorëve ndikues në përzgjedjen e procesit të tranzicionit në Shqipëri. Në çfarë mënyre sistemi mediatik shqiptar ka ndikuar ecurinë e këtij procesi?

Hipoteza 1: Zhvillimi i sektorit ekonomik, dhe si rrjedhojë liberalizimi dhe privatizimi i sektorit mediatik, ndihmojnë procesin e konsolidimit të demokracisë.

Hipoteza 2: Ndërthurja e interesave ekonomike dhe atyre politike me sektorin mediatik ka kontribuar në tejzgjatjen e procesit të tranzicionit dhe në ecjen me hapa të ngadalta drejt konsolidimit të demokracisë shqiptare.

Në këtë punim do të përdoren teknikat cilësore me qëllimin mbledhjen dhe interpretimin e studimeve të larmishme të fushës nëpërmjet konsultimeve të burimeve parësore dhe dytësore.

Metoda cilësore do të fokusohet tek hulumtimi i literaturës shqiptare dhe të huaj, nëpërmjet të cilës do të mundësohet identifikimi dhe përshkrimi i fenomeneve karakterizues të procesit të tranzicionit.

3.1 Tranzicioni shqiptar drejt demokracisë

Me termin tranzicion do të nënkuptojmë procesin e kalimit të një vëndi nga një sistemi politik jo demokratik në një sistem demokratik. Ky proces i referohet intervalit midis përmbyesjes së rregjimit dhe konsolidimit të sistemit demokratik. Në këtë punim termin tranzicion do ta konsiderojmë si referues jo vetëm të sferës politike por edhe ekonomike e sociale.

Përpara se të analizojmë vecoritë e procesit të tranzicionit është e nevojshme të identifikojmë karakteristikat e nevojshme për të konsideruar një sistem demokratik?

Studiuesit e fushës japin përkufizime të ndryshme rreth demokracisë. Sipas traditës Shumpeteriane, që një sistem politik të konsiderohet demokratik duhet që vendimmarrësit të zgjidhen nëpërmjet zgjedhjeve të drejta, të ndershme dhe periodike.

Për Shumpeter, demokracia nuk është tjetër vecse një metodë për seleksionimin e lidershipit që konkuron në tregun elektoral duke kërkuar konsensusin e qytetarëve (Huntington, S. 1998).

Për të përkufizuar një shtet demokratik nuk mjafton vetëm legjitimiteti i pluralizmit politik dhe zhvillimi i zgjedhjeve të lira. Nevojitet pavarësia e sistemit gjyqësor, respektimi i kushtetutës, decentralizimi i pushtetit, ndarja e pushteteve dhe sigurimi i lirisë të informacionit dhe e mjeteve të komunikimit.

Sikurse konfirmohet edhe nga studiues të fushës, procedura kryesore e demokracisë është përzgjedhja e drejtuesve me anën e zgjedhjeve konkurruese nga njerëzit që ata qeverisin. Për të konsideruar zgjedhjet e lira ato duhet të jenë të rregullta dhe të pavarura nga forcat qeverisëse, por vetëm zgjedhjet e lira nuk mund të vlerësohen si një faktor i mjaftueshëm për të konsideruar të përfunduar procesin e tranzicionit. Ato mund të konsiderohen si hapi i parë drejt procesit të tranzicionit por jo ai përfundimtar. Që gara zgjedhore e kandidatëve dhe pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhje të ketë kuptim, demokracia liberale duhet të plotësojë kushtet minimale të lirisë civile (Biberaj, E. 2011).

Është pikërisht koncepti i zgjedhjeve të lira që përfshin dhe ekzistencën e lirisë së shprehjes nëpërmjet medias të lirë, si mjet i rëndësishëm për zhvillimin me efikasitet të debatit politik publik.

Në këtë këndvështrim mjetet e komunikimit duhet të funksionojnë si instrumenta nëpërmjet të cilave aktorët politikë mund të fitojnë mbështetjen e qytetarëve, por që qytetarët të bëjnë zgjedhjen e tyre ata duhet të jenë të informuar dhe pjesëmarrës aktiv në opinionin publik.

Njëkohësisht funksionet normative të medias duhet të bazohen tek karakteristikat e demokracisë liberale si (Norris, P. 2000):

Krijimi i hapësirës së nevojshme për një debat publik mbi çështje të interesit publik.

Roli i gazetarit si "rojtare" të fuqisë që rrjedh nga pushteti.

Mobilizues të pjesëmarrjes të qytetarëve në proceset politike.

Në analizën e faktorëve karakterizues të procesit të tranzicionit në shqipëri vlen të theksohet në vecanti roli i rëndësishëm që ka ushtruar strukturimi i rregjimit totalitar në mënyrën e perceptimit të shtetit nga individët dhe në hedhjen e hapave të parë drejt procesit demokratik.

I karakterizuar nga një parti e vetme dhe i drejtuar nga një lider i vetëm, rregjimi ka ushtruar një kontroll total mbi shoqërinë dhe mbi mjetet e komunikimit masiv.

Sistemi mediatik i karakterizuar nga mungesa e traditave demokratike e pluraliste të konsoliduara ka qënë totalisht në funksion të propagandës. Për shkak të izolimit total të shtetit shqiptar gjatë diktaturës procesi i tranzicionit drejt demokracisë u zhvillua me hapa më të ngadaltë se në vendet e tjera ish-komuniste. Fakti që rregjimi karakterizohej nga identifikimi i partisë me strukturat më të larta të shtetit reflektoi probleme ideologjike dhe institucionale gjatë periudhës së parë të tranzicionit.

Para viteve '90 në shqipëri nuk ekzistonin institucionet e domosdoshme për të konsideruar një shtet si demokratik, mungonte liria e mediave dhe pavarësia e sistemit gjyqësor.

Në dallim nga tranzicionet demokratike, tranzicioni postkomunist në shqipëri duhet të përfshinte jo vetëm transformimin politik të shoqërisë nga një sistem autoritar në një sistem demokratik por edhe transformimin ekonomik të saj nga një ekonomi e komanduar në një ekonomi të lirë tregu (Tarifa, F. & Krisafi, K. & Tarifa, E. 2009).

Përbërja e institucioneve të para demokratike në shqipëri mund të shihet si një tentativë për të replikuar modelet funksionale të Europës Perëndimore. Demokratizimi që ndodhi në vendet e tjera më probleme të ngjashme me vëndin tonë u pa si një model politik e kulturor.

Në shqipëri procesi i kalimit në demokraci u shoqërua me diferencimin strukturor të shoqërisë dhe jo me reforma të qarta institucionale. Në aspektin institucional, vështirësitë që shoqëruan periudhën e parë të tranzicionit ndikuan në dobësimin e kapacitetit administrativ të qeverisë shqiptare, duke rritur me rritme të shpejta nivelin e mosbesimit të qytetarëve ndaj institucioneve demokratike.

3.2 Faktorët ndikues në stabilitetin dhe konsolidimin e demokracisë.

Ndërsa në shumë shtete komuniste tranzicioni nga autoritarizmi në demokraci ka qënë i shpejtë, studiuesit janë të mendimit se konsolidimi i demokracisë në Europën qëndrore dhe lindore parashikohej i gjatë, konfliktual dhe jo përfundimtar (Schmitter,

P.C. & Karl, T.L. 1991). Duke pasur parasysh kushtet e vështira në të cilat filloi demokratizimi në shqipëri, parashikohej se periudha e tranzicionit do të ishte më e gjatë dhe më e vështirë se në vendet e tjera ish komuniste (Biberaj, E. 30).

Tranzicioni i shoqërisë shqiptare ka kaluar nëpërmjet fazave të ndryshme, duke shfaqur tipare të ndryshme dhe shpeshherë kontradiktore (Pëllumbi, S. 55). Ndër tre fazat më të rëndësishme do të konsideronim:

1990-1998 periudhë që fillon me zgjedhjet e para pluraliste dhe përfundon me miratimin e kushtetutës.


Faza e dytë, 1998-2006 e karakterizuar nga një demokraci e brishtë dhe problematike.

Faza e tretë, 2006 e në vazhdim, periudhë që shënon nënshkrimin e marrëveshjes së Stabilizim Asocimit në Bashkimin

European.

Procesi i demokratizimit të shqipërisë është ndeshur me sfida të mëdha ekonomike, politike dhe shoqërore. Nëse do i referoheshim një faktori të rëndësishëm në analizën e procesit të konsolidimit ai do të ishte faktori ekonomik. Ekziston një lidhje e fortë ndërmjet nivelit të zhvillimit të ekonomisë, lirisë ekonomike dhe ecurisë së procesit të konsolidimit, kjo pasi një shoqëri moderne dhe e industrializuar formon një shoqëri të arsimuar dhe që favorizon sistemin demokratik (Huntington 2011).

FIG 1. POZICIONIMI I SHQIPËRSIË NË KLASIFIKIMIN INDEX OF ECONOMIC FREEDOM 2007-2015



Sikurse mund të shohim edhe nga tabela e mësipërme në dy dekadat e fundit janë alternuar nivele të ndryshme të lirisë së tregut.

Njëkohësisht, zhvillimi ekonomik mund të konsiderohet edhe si shtysa kryesore për liberalizmin dhe privatizimin e sektorit mediatik. Përveç nivelit të zhvillimit ekonomik dhe kulturës demokratike, në konsolidimin e demokracisë duhet të marrim në konsideratë edhe faktorët kontekstualë si; trazirat, konfliktet, inflacioni shqiptar (Biberaj, E. 2011). Faktorë të cilët ndikojnë në uljen e besimit të popullit në efikasitetin e procesit të demokratizimit të vendit.

Një tjetër faktorët, i një rëndësie të vecantë që ndikon në stabilitetin e rregjimeve demokratike është aftësia e elitave politike për të punuar së bashku në zgjidhjen e problemeve me të cilat ndeshet shoqëria dhe për të mos i shfytëzuar ato probleme për përfitimet e tyre politike dhe materiale.

3.3 Marrëdhënia e krijuar ndërmjet sistemit politik dhe atij mediatik

Që prej shekullit të tetëmbëdhjetë, media dhe funksionet e ushtruara prej saj janë bërë faktorë influencues në ecurinë e proceseve politike demokratike. Në sistemet politike demokratike, roli i medias është vendimtar si në transmetimin e informacionit politik ashtu edhe në formësimin e opinionit publik (Mc Nair, B. 2008).

Që sistemet demokratike të konsiderohen të tilla ato duhet të zotërojnë disa prej karakteristikave dalluese të demokracisë liberale si: kushtetueshmëria, pjesëmarrja e lirë në zgjedhje dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme, aftësia e qytetarëve për të bërë zgjedhje racionale. Është pikërisht informacioni që qarkullon në media që mundëson informimin e qytetarëve dhe pjesëmarrjen e tyre në procesin e vendimmarrjes (Mc Nair, B. 2008).

Nga sa u tha më sipër rezulton se në vlerësimin e një shteti demokratik është e rëndësishme jo vetëm ekzistenca e pluralizmit politik por edhe e pluralizmit të informacionit.

Tranzicioni social, politik dhe ekonomik që shoqëroi kontekstin shqiptar ka ndihmuar në krijimin e një raporti ndërvarësie ndërmjet sistemit mediatik dhe atij politik. Në shqipëri, edhe pse me përmbysjen e rregjimit komunist sistemi mediatik ka pësuar ndryshime të thella, aktualisht rezulton e vështirë të konsiderohet plotësisht si pushteti i katërt, kjo për shkak të raportit të ndërvarësisë të përmendur më sipër.

Në fazën e parë të demokratizimit media ka pasur mundësinë të ushtrojë influencën e saj mbi vendimmarrjen politike por me kalimin e kohës rritja e skepticizmit ndaj organeve mediatike është shoqëruar me rrënimin e besimit ndaj këtyre organeve.

Izolimi i shqipërisë nga bota e jashtme, nga vlerat dhe parimet e demokracisë, bashkë me mungesën e traditave demokratike, kishte formuar vlera dhe qëndrime që nuk ishin të favorshme për zhvillimin e demokracisë (Biberaj 117).

Ka qënë pikërisht presioni i ushtruar nga përhapja masive e mediave ajo që shpjegon edhe suksesin e efektit domino në demokratizimin e vëndeve të tjera komuniste. Efektet demonstruese në fazën e parë të tranzicionit u mundësuan gjërësisht nga përhapja e komunikimit masiv.

Përgjatë viteve '90 panorama mediatike shqiptare ka hasur ndryshime të herë pas hershme. Në fillim të viteve '90 në sektorin mediatik hasej një nivel i ulët profesionalizmi dhe mungesa e shtypit të pavarur nga autoritetet shtetërore. Gazetat kishin lidhje të ngushta financiare me partitë politike duke u konsideruar nga publiku si instrumenta nën drejtimin e partive politike.


Për sa i përket sektorit radioteleviziv, edhe pas rrënies të rregjimit ka qënë objekt i financimeve dhe kontributeve shtetërore. Thellimi i krizës ekonomike dhe vështirësitë financiare të qytetarëve cuan në rënimin e tirazhit të shtypit të shkruar dhe në krijimin e një interes në rritje drejt televizionit, duke e shndërruar këtë të fundit në një sektor investimi jo vetëm për sipërmarrësit e rinj por edhe për klasën politike (Gritti, R. 2001).

Në Ballkan, ashtu sikundër ndodhi edhe në Azinë Qëndrore, në Ukrainë dhe në Rusi, demokratizimi politik dhe ai mediatik ka qënë i pranishëm në fazën e parë të tranzicionit dhe bashkë me evolucionin e procesit të konsolidimit interesi për demokratizimin e dy sferave më të rëndësishme të shoqërisë ka ardhur duke u zbehur.

Pavarësisht vërejtjeve të nevojshme, rezultojnë se industria mediatike ka luajtur një rol të rëndësishëm në jetën politike dhe ekonomike të shoqërisë. Media duhet të vazhdojë të ushtrojë funksionin e saj, jo vetëm si mjet influencues dhe drejtues i opinionit publik por edhe një platformë ku mund të lindë dhe të formohet debati publik. Sistemi mediatik duhet të konsiderohet si një kanal nëpërmjet të cilit transmetohen mesazhe politike dhe mundësohet krijimi i realitetit social.

Nisur nga ky këndvështrim, liria e medias ka rëndësi të vecantë në procesin e transformimit demokratik. Ajo mund të konsiderohet një tregues i procesit të demokratizimit. Që mediat të jenë pjesë aktive e procesit të zhvillimit të demokracisë ato duhet të jenë të pavarura financiarisht, dhe politikisht.

FIG 1. POZICIONIMI I SHQIPËRISË NË KLASIFIKIMIN PRESS FREEDOM INDEX 2004-2015.



Modeli mediatik stanjant në të cilin Gritti klasifikon shqipërinë karakterizohet nga mungesa e reformave në fushën ekonomike, nga prania e krizave politike dhe e konflikteve të brendshme, nga një nivel i ulët i demokracisë dhe nga një shoqëri civile e dobët. Karakteristika këto të cilat mund të shohim të reflektura edhe tek alternimi i niveleve të ndryshme të pozicionimit të shqipërisë në treguesit e lirisë së shtypit..

Konkluzione

Nga analiza e teorive bashkëkohore rezultojnë se aktualisht është e vështirë të identifikohet një lidhje e drejtëpërdrejtë shkaku-pasojë ndërmjet medias dhe demokracisë (Voltmer, Roënsley 2009). Edhe pse në shqipëri është folur shumë mbi procesin e tranzicionit, hasim mungesë të studimeve të përqëndruara tek roli që sistemi mediatik mund të ketë luajtur në zgjatjen e këtij procesi.

Ashtu sikurse u vëzhgua nëpërmjet analizës të periudhës së tranzicionit në shqipëri mund të konfirmojmë që zhvillimi i demokracisë kushtëzohet nga prania e një debati publik të lirë dhe të hapur. Debat publik mundësohet vetëm nëpërmjet

garantimim të lirisë së shtypit e informacionit dhe nëpërmjet ndërgjegjësimit të shoqërisë civile për rolin e rëndësishëm që ka media në jetën sociale, politike dhe ekonomike të një shteti. Është pikërisht liria e shtypit që luan një rol të rëndësishëm në procesin e transformimit demokratik dhe në formimin e demokracisë.

Që media të konsiderohet e lirë dhe efikase në procesin e demokratizimit të një shteti ajo duhet të jetë e pavarur nga interes ekonomike dhe politike dhe duhet të funksionojë si një hapësirë e nevojshme nëpërmjet të cilës qytetarët do të informohen dhe do të formojnë opinionin e tyre publik. Vetëm në këtë mënyrë mediat dhe qytetarët mund të kontribuojnë realisht në demokratizimin e një shteti.

Përgjatë punimit të mësipërm rezulton se është e nevojshme që partitë politike shqiptare të hedhin hapat e parë drejt bashkëpunimit ndërmjet tyre për një proces të përbashkët demokratizimi. Pikërisht mungesa e bashkëpunimit midis klasave politike dhe mos respektimi i rregullave demokratike kërcënon konsolidimin e plotë të demokracisë (Biberaj, E.).

Duke e konsideruar të përfunduar procesin e tranzicionit drejt demokracisë, vëmendja e shoqërisë civile, mediave dhe elitës politike duhet të fokusohet tek cilësia e demokracisë.

Bibliografia

- Biberaj, E. (2011). Shqipëria në tranzicion. Rruga e vështirë drejt demokracisë 1990-2010”, AIIS, Tiranë, 146.
- Bianchini, S. (1992). La transizione postcomunista in Jugoslavia, Albania e Romania, Franco Angeli, Milano.
- Eco, U. (1964). Apocalittici e integrati. Comunicazioni di massa e teorie della cultura di massa, Bompiani, Milano, 180-187.
- Gritti, R. (2001). Postcomunismo e media, Meltemi, Roma.
- Grilli Di Cortona, P. (2009). Come gli stati diventano democratici, Laterza, Roma-Bari.
- Huntington, S. (1998). La terza ondata. I processi di democratizzazione alla fine del XX secolo, Il Mulino, Bologna, 146-149.
- Mc Nair, B. (2009). Hyrje në komunikimin politik. Uet press, Tiranë.
- Krasniqi, A. (2006). Partitë politike në shqipëri 1920-2006. Historia dhe tiparet e partive parlamenteve dhe të zhvillimeve politike, Eurorilindja, Tiranë.
- Pëllumbi, S. (2007). Pluralizmi politik, Dudaj, Tiranë.
- Schmitter, P.C. & Karl, T.L. (1991). Èhat democracy is... and is not. Journal of Democracy. Vol.2. N.3. The Johns Hopkins University.
- Tarifa, F. & Krisafi, K. & Tarfia, E. (2009). Paradigma e tranzicionit demokratik:”fundi” i tranzicionit apo një tranzicion “pa fund”. Ombra GVG, Tiranë.
- Voltmer, K. (2001). The mass media and transitions to democracy, European Political Science vol. 1.
- Zarrilli, L. (1999). Albania, Geografia della transizione, Franco Angeli, Milano.

MENAXHIMI I KOHËS NË ORGANIZATAT PUBLIKE – RASTI I ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS

SHEFQET DERVISHAJ

shefqetdervishaj@hotmail.com

ABSTRAKT

Problemi i menaxhimit të kohës daton qysh para njëqind vjetësh. Deri në vitet e shtatëdhjeta fjala menaxhim i kohës nuk ka hyrë në përdorim. Në vitet e tetëdhjeta menaxherët filluan të mendojnë për kohën si resurs i cili mund të menaxhohet. Koha është një burim i domosdoshëm dhe i pa zëvedsueshëm në kryerjen e detyrave. Koha është pasuria e çmueshme e menaxherëve dhe po e humbën atë nuk mund ta ruajnë e as ta zëvendësojnë dot. Sa më mirë që e shfrytëzojmë kohën aq më shumë gjëra do të arrijmë t'i kryejmë. Menaxhimi i kohës është një nga kërkesat më thelbësore për mbarëvajtjen maksimale të produktivitetit si në jetën personale ashtu edhe në atë afariste. Koha është gjëja më e shtrenjtë që njeriu mund ta harxhojë, prandaj kohën duhet ta shfrytëzojmë menqur. Parat e humbura mund të kompenzohen, kurse koha e humbur nuk mund të kthehet ajo është e humbur përgjithmonë. Kohën nuk mund ta ndalim, nuk mund ta zgjasim dhe as ta kthejmë prapa. Çfarë mundemi ne të menaxhojmë? Ne mund ta menaxhojmë veten në kohë dhe duhet ta kuptojmë natyrën e këtij fenomeni, „kohë” që të mund ti përshtatem. Nga këto që u thanë më lartë mendoj që me studimin dhe menaxhimin e mirë të kohës mund të krijohet një kultur e re si në aspektin organizativ, komunikues, planifikues pra në përgjithësi në çdo sferë të menaxhimit dhe me këtë edhe një kultur e re e sipermarrrjes.

Fjalë kyç: *Menaxhim i kohës, planifikimi, monitorimi, performansa*

1. Hyrje

Në kuadër të këtij punimi, përcaktimi im është fokusuar në menaxhemin e kohës si të menaxherëve ashtu edhe të punësuarëve në sektorin publik si dhe ndikimi i menaxhimit të kohës në rritjen e performances të këtyre organizatave.

Menaxhimi i kohës ka zënë një vend të rëndësishëm në vendet e zhvilluara e me këtë pasi edhe Kosova edhe Shqipëria janë të orientuara që t'i bashkohen Bashkimit Evropian është shumë me rëndësi që të bëhet një analizë e menaxhimit të kohës.

Shfrytëzimi efikas i kohës është koncept që për të gjithë është i njohur. Të gjithë ne kemi probleme me shfrytëzimin të kohës, asnjëherë nuk kemi kohë të mjaftueshme për t'i përfunduar ato punë që ne kemi pasur në plan t'i kryejmë, por kur t'i shijojmë të tjerët rreth nesh duket se ata kanë kohë më shumë se sa ne për t'i kryer punët e veta.

Në këtë punim kam bërë analizë të menaxhimit të kohës në organizatat publike më konkretisht në Administratën Tatimore të Kosovës, është bërë analiza e planit të punës dhe të arriturve gjatë periudhës që ka të bëjë me shfrytëzimin e kohës së punës, menaxhimi aktual i kohës, problemet që hasin si menaxherët ashtu edhe të punësuarit lidhur me menaxhimin e kohës, është bërë një analizë deri në detaje pse ka mosshfrytëzim të kohës së punës së planifikuar dhe kam dhënë disa rekomandime lidhur me mundësinë e përmirësimit të menaxhimit të kohës.

Të dhënat janë marr nga burime të ndryshme brenda ATK-së siq plani vjetor për vitin 2014 dhe nga raporti i rezultateve të arritura për vitin 2014 por duke u fokusuar vetëm në menaxhimin e kohës duke i abstraguat të dhënat tjera të cilat nuk janë relevante për këtë punim. Gjithashtu janë bërë intervistat ku janë marr opinionet lidhur me menaxhimin e kohës si dhe barrierat që kanë qenë për mos arritje të menaxhimit të mirë të kohës. Gjithashtu kam konsultuar edhe literaturën që ka të bëjë me menaxhim të kohës si dhe literaturë tjetër të nevojshme.

2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Duke e parë se problemi i menaxhimit të kohës është një problem që i mundon si menaxheret e të gjitha niveleve ashtu edhe të punësuarëve si në organizatat publike të cilat janë të obliguara të ofrojnë shërbime të shpejta dhe cilësore ashtu edhe të kompanitë private që kanë për qëllim t'i rrisin fitimet e veta, në këtë punim jamë i fokusuar që të shtjellojë problemin e menaxhimit të kohës tek organizatat publike, konkretisht analizën e menaxhimit të kohës në Administratën Tatimore të Kosovës, sfidat me të cilat ballafaqohet, përparësitë që ka ky institucion si dhe specifikat e tij.

Qëllimi i këtij punimi është që të bëhet një analizë lidhur me menaxhimin e kohës dhe të gjitha janë të përmbledhura në disa objektiva:

Objektiv i parë do të jetë analiza e menaxhimit aktual të kohës, dobësitë dhe përparësitë,
Identifikimi i faktorëve që kanë ndikuar në përmbushjen ose mospërmbushjen e menaxhimit të kohës,
Hulumtimi i të dhënave sasiore lidhur me shfrytëzimin e kohës së punës dhe
Nxjerrja e konkluzioneve dhe dhënja e rekomandimeve

Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Problem i menaxhimit të kohës është shumë i rëndësishëm në çdo aspekt të jetës, si në jetën private ashtu edhe në botën e biznesit. Pasi në këtë punim fokusi im do të jetë menaxhimi i kohës në organizatat publike konkretisht në Administratën Tatimore të Kosovës e cila është e një rëndësie të veçantë për Kosovën pasi të hyrat buxhetore kryesisht mbulohen nga ky institucion, me këtë edhe performanca e këtij institucioni varet shumë nga menaxhimi i kohës dhe ofrimi i shërbimeve efektive tatimpaguesëve që fundi i fundit janë mbushësit kryesor të buxhetit.

Në këtë punim jamë bazuar në dy pyetje kërkimore të cilat po i parashtrohoj si më poshtë:

Si ndikon menaxhimi i kohës në ngritjen e performances në organizatat publike?

Si ndikojnë faktorët e mjedisit të brendshëm (burimet, kapacitetet dhe kompetencat bazë) në menaxhimin e kohës në organizatat publike ?

Nga këto pyetje kërkimore ka dal hipoteza

Faktorët e mjedisit të brendshëm (burimet, kapacitetet dhe kompetencat bazë) janë të lidhur pozitivisht me performancën menaxheriale dhe produktivitetin e të punësuarëve në organizatat publike.

Për realizimin e këtij punimi do të përdori një metodologji duke përdorur të dhëna sasiore dhe cilësore të marra nga burimet primare, pra nga shënimet që do më ofrohen nga përgjegjësitë që janë në Administratën Tatimore të Kosovës.

Të dhënat sasiore do të përpunohen me programin softverik (EXCEL) dhe do t'i paraqes në tabela si dhe do të përdori metoda statistikore për të ardhur deri të përfundimet e nevojshme.

4. Analizë, interpretim të dhënash

Përshkrim i shkurtër për Administrata Tatimore e Kosovës

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) është agjension në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës. Misioni i ATK-së është të mbledh të hyra nga tatimet brenda territorit të Kosovës, të cilat mundësojnë financimin në mënyrë të drejtë dhe transparente të shërbimeve publike dhe nevojave të qytetarëve siq janë :infrastruktura, siguria, arsimiti, shëndetësia ,programet e mirëqenies sociale etj. andaj është përgjegjesi e tatimpaguesëve që përmes deklarimit dhe pagesës së detyrimeve tatimore të ndihmojnë në zhvillimin ekonomik të shtetit tonë.

ATK e ka drejtorinë e përgjithshme në Prishtinë në kuadër të së cilës ka departamente të ndryshme siq janë departamenti i burimeve njerzore, kontrollit, ankesave të tatimpaguesëve, edukimit të tatimpaguesëve, teknologjia informative, zyra ligjore, departamenti i auditimit të brendshëm, departamenti i modernizimit. Nga të gjitha departamentet më i rëndësishmi është departamenti i operacioneve në ATK sepse operacionet janë departamenti që është më i madhi numerikisht dhe ka kontaktin direkt me tatimpaguesin, është departamenti ku bëhet edhe ofrimi i shërbimeve por edhe vjelja e tatimeve nga tatimpaguesit. Ky departament është i organizuar në njësitë regjionale apo më mirë të themi Regjionet që janë të organizuara kryesisht në bazë teritoriale siq janë Prishtina 1,2 dhe 3, Mitrovica, Peja, Prizreni, Gjakova, Ferizaj, Gjiçani dhe Njësia e tatimpaguesëve të mëdhenjë.

Menaxhmenti

Struktura menaxheriale e ATK-së është e organizuar nga nivele të linjes së parë deri tek top menaxhmenti.

Top menaxhmentin e përbenë drejtori general dhe zëvendësdrejtorët e departamenteve siq janë departamenti i operacioneve, përmbushjes, teknologjisë informative, shërbimeve të përbashkëta, auditimit. Ky rang i menaxhmentit merret me marrjen e vendimeve strategjike të ATK-së, jep rekomandime të caktuara niveleve më të ulta menaxheriale dhe pranon raportime nga niveli i mesëm menaxherial.

Nivelin e mesëm të menaxhmentit e përbejnë menaxherët e regjioneve. Ky nivel i menaxherëve merren me udhëheqjen e regjioneve të caktuara në kryerjen e punëve dhe detyrave të përcaktuara dhe të kornizuara nga planet vjetore dhe strategjike.

Niveli i ulët menaxherial janë udhëheqësit e ekipeve që merren me menaxhimin e ekipeve të organizuara në kuadër të regjionit që përbehen nga 5-8 inspektor tatimor apo ekipi i mbledhjes së detyrueshme që përbehet nga 7-8 zyrtar të mbledhjes së detyrueshme.

Veprimet e ATK-së janë të orientuara nga plani strategjik dhe nga planet vjetore të cilat janë të detajizuara për qdo segment të veçantë të ATK-së.

Në kuadër të ATK-së janë të përcaktuara punët dhe detyrat dhe dihet saktë se kush duhet ti kryej detyrat, si do të bëhet grupimi dhe sistematizimi i detyrave dhe kush kujt i raporton për detyrat që janë të përcaktuara me plan. Duke u nisur nga inspektorët të cilët janë të kyqur direkt në punët operative që për punëve kryer ditore i raportojnë udhëheqësit të ekipit që është niveli i linjës së parë menaxheriale. Në hierarkinë e detyrave udhëheqësi i ekipit për punën e ekipit të vet i raporton menaxherit regjional që në fakt është linja e mesme menaxheriale në ATK. Për detyrat dhe obligimet e kryera nga ana e regjionit, menaxheri i raporton menaxhmentit të lartë në ATK gjegjësisht zëvendës drejtorit të operacioneve.

Menaxherët regjional konform legjislacionit dhe rregullave të ATK-së bëjnë motivimin, drejtimin e aktiviteteve të puninjësve, bëjnë zgjedhjen e kanaleve efektive të komunikimit si dhe zgjedhje e konflikteve eventuale.

Pas përfundimit të këtyre proceseve menaxheriale, bëhet monitorimi i performances së punonjësve të ATK-së duke krahasuar performancën me Standardet e përcaktuara me plan me qëllim që të bëhen përmirësime dhe eventualisht devijimeve të mundëshme në raport me standardin e përcaktuar.

Planifikimi në kuadër të ATK-së

Deri në vitin 2010 ATK-ja nuk ka bërë ndonji plan strategjik apo afatgjatë. Ka vepruar me plane vjetore të cilat kanë qenë të detalizuara.

Në vitin 2010 është nxjerr plani strategjik I ATK-së .Ky plan e përfshin periudhën 2010- 2015. Në këtë plan janë përcaktuar orientimet strategjike të veprimit për sigurimin e përmbushjes tatimore dhe respektimi i legjislacionit tatimor të Kosovës. Bazuar në strategjinë ATK-ja do të fokusohet në përdorimin sa më optimal të kapaciteteve për të përmbushur kërkesat e lartpërmendura dhe kërkesat tjera, të cilat rrjedhin nga plani strategjik.

Një element që duhet përmendur që është nxjerr nga plani strategjik ka të bëjë me hendekun tatimor që do të thotë që nga potenciali i mundshëm tatimor proporcioni në mes të tatimit të mbledhur dhe hendekut tatimor të zvogëlohet në favor të tatimit të mbledhur si në aspektin e përgjithshëm tatimor ashtu edhe të tatimeve të caktuara veq e veq.

Përgjegjësi e ATK-së është që të administroj zbatueshmërinë e të gjitha llojeve të tatimeve të parapara me legjislacionin tatimor të Republikës së Kosovës. Kjo do të thotë që ATK-ja duhet të siguroj që tatimpaguesit ta respektojnë në tërësi legjislacionin tatimor.

Në këtë rrafsh duhet përmendur përpunimin e metodave më të thjeshta e të kuptueshme,eliminimin e vështirsive administrative,asistimin në procesin e kryerjes së obligimeve,ofrimi i shërbimeve on-line,ofrimi i shërbimeve përmes qendres së thirrjeve dhe komunikimi i drejtëpërdrejtë me publikun,informimi i shpejtë dhe me kohë sin ë ueb-faqet e ATK-së,brosurave,seminareve etj. Nga plani strategjik nxirren planet vjetore të veprimit të operacioneve .Pra kemi të bëjmë me plane operacionale, të detajuara për qdo regjion veq e veq,plan të detajuar për ekipe të kontrollit dhe për qdo inspektor apo zyrtar të tatimeve.Duhet cekur se më parë planet e regjioneve janë diskutuar nga baza duke filluar nga inspektori,ekipi i kontrollit dhe regjioni të cilat janë derguar në departamentin e planit dhe analizës,janë analizuar dhe janë unifikuar në nivel të ATK-së. Janë përcaktuar prioritetet e punës dhe nga kjo ka rrjedh analiza e rrezikut dhe vendosja e prioriteteve për trajtimin e rrishtit.

Nga plani vjetor janë shkoqitur dhe janë nxjerrë planet ditore,javore,mujore,tremujore dhe gjashtëmujore.E gjithë kjo është bërë për të menaxhuar kohën në mënyrën më të mirë të mundshme.

Duke u nisur nga njësia me e vogel që është ekipi bëhen plane ditore të detajuara dhe të kordinuara të cilat në fund të qdo dite pune analizohen dhe nese ka ndonjë vërejtje të devijimit nga plani i përcaktuar,bëhet korigjimi i atyre devijimeve. Njëkohsisht udhëheqësit e ekipeve bejnë plane javore të cilat i prezentohen menaxherit regjional dhe në fund të javës bëhet analiza e realizimit të atij plani.Kështu bëhet edhe me planet tjera siq janë ato mujore,tremujore dhe gjashtëmujore.

Në ATK planet ditore si plane formale mund të ndryshohen dhe jepen plane joformale që rëndom janë plane ditore ose thënë më mirë plane të qastit që paraqiten sipas nevojve ditore.

Për të bërë përcjelljen e punës dhe menaxhimin e kohës si të punësuarëve ashtu edhe të stafit menaxhues është nxjerr një vegël në programin kompjuterik që njihet me shkurtesën VKME (vizita,kontrolla,mbledhja dhe edukimi) e cila e ka rolin e dosjen elektronike për secilin tatimpagues por njëkohësisht aty evidentohet edhe puna e çdo të punësuarit në ATK.Pra në këtë vegël bëhet raportimi i punës dhe mbahet evidenca për punën e secilit.

Anliza e menaxhimit të kohës

Në planin vjetor të punës në departamentin e operacioneve janë të precizuara numri dhe koha për lloje të vizitave dhe numri i vizitave.Më poshtë po japim një tabelë se si është e kalkuluar koha efektive për këtë departament.

TABELA NR.1 LOGARITJA E DITËVE TË PUNËS PËR NJË TË PUNËSUAR NË ATK

A.Kalkulimi i ditëve të punës së një punëtori	
52 x 5 = 260	(52 javë x 5 ditë pune = 260 ditë pune)
260 - 22 = 238	(260 ditë pune - 22 ditë pushimi vjetor = 238 ditë pune)
238 - 8 = 230	(238 ditë pune - 8 ditë festa = 230 ditë pune)
230 - 7 = 223	(230 ditë pune - 7 ditë të mundshme pushim mjekësor = 223 dp)
223 - 6 = 217	(223 ditë pune - 6 ditë të mundshme mesatre trajnim = 217 dite)
217	(ditët mesater të punës së një punëtori gjatë viti 2014)
B.Orët efektive të punës për vizita	
8 orë(h)	(orari i rregullt i punës 08:00 - 16:00)
8h - 1h = 7h	(1 orë pauza e drekës 12:00-13:00)
7h - 1h = 6h	(1 orë rruga:vajtje - ardhje gjatë vizitave në teren)
6h - 1h = 5h	(1 orë rregullimet e dosjeve,takimet e mengjesit,etj)
5h	(orët efektive për planifikimin e vizitave dhe kontrollave)
C.= (A x B) Kalkulimi i orëve efektive të punës së një punëtori brenda vitit 2014	
217	(ditët mesatare të punës së një punëtori gjatë viti 2014)
5	(orët efektive për planifikimin e vizitave dhe kontrollave)
1085	(fondi i përgjithshëm i orëve për një punëtorë-inspektor brenda viti 2014)

Burimi:Plani i detajuar i trajtimit të reziqeve për vitin 2014 ATK

Nga tabela e mësipërme mund të konstatojmë që për vitin 2014 orët e planifikuara që i punësuarit duhet t'i kalojë në vizita tek tatimpaguesi dhe koha që i nevojitet për të kryer kontrollat është 1085 orë pune.Këto orë pune do të shpërndahen për numër të caktuar vizitash ashtu edhe në kontrolla.Nga plani i gjithmbarshëm i orëve efektive 65.80 % janë të ndara për vizita dhe 34.20 % për kontrolla.Kjo perqindje është nxjerr nga plani i vizitave të përgjithshme (185291 fondi total i orëve i ndarë për vizita/60117 plani total i vizitave= 3orë mesatarja për një vizitë) sepse është e ndarë koha për vizita te bizneset e mëdha që është 5 orë pune efektive dhe 2 orë e 30 minuta për bizneset më të vogla.Për këtë rast studimi i kam marr orët mesatare që është 3 orë për një vizitë dhe planin e kontrolleve që është 4 (katër) x 93 orë = 372 orë.

Nga plani prej 1085 orë efektive,714 janë për vizita dhe 372 për kotrolla.Nëse e marrin tërsi për të gjitha regjionet na del që koha efektive në dispozicion për vizita është (253 x 714=180642 orë) kurse për kontrolla është (253 x 372 = 94116 orë)

TABELA 2.PLANI DHE REALIZIMI I VIZITAVE GJATË VITIT 2014

Regjioni	Plani i vizitave per inspektor	Numri i inspektorëve	Gjithsejt vizita	Realizimi i vizitave	Përqindja e realizimit të planit
1	2	3	4(2*3)	5	6(5/4)
Regjioni 1	238	33	7854	8705	110.83
Regjioni 2	238	28	6664	5907	88.64
Regjioni 3	238	34	8092	8983	111.01
Regjioni 4	238	30	7140	6004	84.08
Regjioni 5	238	24	5712	6114	107.03
Regjioni 6	238	41	9520	9418	98.92
Regjioni 7	238	10	2380	2409	101.21
Regjioni 8	238	28	6664	6490	97.38
	238	23	5474	4255	77.73
TOTAL		253	60117	58285	96.95

Burimi:Plani vjetor dhe raporti vjetor i punës 2014, ATK

Nga tabela e mësipërme mund të konstatojmë se realizimi i planit në nivel të të gjitha regjioneve sa u përketë numrit të vizitave është 96.95 %.

Por ky nuk është tregues që mund të na ndihmojë lidhur me menaxhimin e kohës.Në vazhdim në tabeln nr3.kam paraqitur numrin e kontrollave të planifikuara dhe të realizuara sa i përketë numrit kontrollave dhe shpenzimi i orëve për periudhen e caktuar.Të gjitha të dhënat empirike janë marrur nga plani vjetor per vitin 2014 kurse realizimi i kontrollave dhe shpenzimi i orëve është marrur nga dokumentet burimore.

TABELA 3.PLANI DHE REALIZIMI I KONTROLLAVE PËR VITIN 2014

Regjioni	Plani i kontrollave	Orët e planifikuara	Gjithsejt orët për kontrolla	Realizimi i kontrollave	Orët e shpenzuara	Gjithsejt orët e shpenzuara	Perqindja realizimit kontroll.
	1	2	3(1*2)	4	5	6(4*5)	7(4/1)
Regj. 1	132	93	12276	123	124	15252	93.18
Regj. 2	112	93	10416	109	209	22781	97.32
Regj. 3	136	93	12648	135	120	16200	99.26
Regj. 4	120	93	11160	103	85	8755	85.83
Regj. 5	104	93	9672	90	77	6930	86.53
Regj. 6	164	93	15252	183	64	11712	111.58
Regj. 7	40	93	3720	38	65	2470	95.00
Regj. 8	112	93	10416	121	91	11011	108.03
Regj. 9	92	93	8556	65	58	3770	70.65
	1012	93	94116	967	102	98881	95.55

Burimi: Plani vjetor dhe realizimi i punës,ATK

Nga tabela e mësipërme mund të konkludojmë se plani i kontrollave sa i përketë numrit të tyre është realizuar 95.55 %.

Plani për realizimin e një kontrolli është 93 orë kurse realizimi ka qenë 102 orë(98881/967).Kjo do të thotë se kemi shpenzim më të madh të orëve efektive të punës për një kontroll.Nga koha që është në dispozicion për kontrolla në aspektin total 94116 orë të planifikuara për të gjitha regjionet janë shpenzuar më shumë kohë në kontrolla,pra janë shpenzuar 98881 orë pune efektive.Kjo kohë e shpenzuar nuk është menaxhuar mirë nga disa regjione ku kemi në disa raste më shumë se dyfishi i kohës së shpenzuar krahasuar me atë të planifikuar.

Për të analizuar menaxhimin e kohës së planifikuar dhe të realizuar në vizita kam përzgjedhur tri regjione si më reprezentative dhe në secilin nga tre regjionet nga një ekip ku është analizuar shfrytëzimi i kohës së punës e cila është planifikuar për vizita.

Nga të dhënat empirike që janë marrur dhe nga analizat e bëra kam ardhur në përfundim si në vijim ku në mënyrë të ndarë .

TABELA 4. PLANI DHE REALIZIMI I VIZITAVE PËR 2014(TË MOSTRUARA NË TRI REGJIONE TË NDRYSHME)

Ekipi	Plani i vizitave	Orët e planifikuara	Gjithsejt orët për vizita	Realizimi i vizitave	Orët e shpenzuara	Gjithsejt orët e shpenzuara	Perqindja e realizimit të vizitave
1	2	3	4(2*3)	5	6	7(5*6)	8(5/2)
Ekipi A	1428	3	4284	1508	1.41	2126	105.60
Ekipi B	1666	3	4998	2012	1.02	2057	120.76
Ekipi C	1428	3	4284	1017	1.45	1476	71.22
	4522	3	13566	4537	1.25	5659	100.33

Burimi:Plani vjetor i ATK 2014 dhe përpunuar nga autori

Në tabelen 4. shihet se plani numerik i vizitave është realizuar 100.33 %.Për këto vizita janë shpenzuar 5659 orë efektive. Ekipi A ka gjashtë të punësuar dhe plani i vizitave është(6 inspektor x 238 vizita = 1428),ekipi B 1666 vizita (7 inspektor X 238 vizita) dhe ekipi C ka të planifikuar 1428 vizita (6 x 238).

Nga rezultatet e nxjerra nga mostrimi i popullatës prej 253 të punësuarve ku janë analizuar 19 prej tyre,shpenzimet e kohës së tyre për vizita del se për një vizitë nevojiten 1.25 njësi apo 1 orë e 15 minuta.Nëse e marrim këtë si rezultat të tërë popullatës atëherë kemi këtë shpenzim të kohës si në vijim: Në tabelen nr.3 orët e shpenzuara për një kontroll janë 102 kurse për një vizitë 1 orë e 15 minuta.Kontrolla të planifikuara janë 1012 kurse të realizuara 967.Plani i vizitave është 60117,koha e planifikuar për një vizitë është 3 orë. Janë realizuar kontrolla 967 x 102 orë = 98881 orë pune dhe realizimi i vizitave është 58285 x 1h.15min.= 72856 orë punë. Plani i përgjithshëm i orëve të planifikuara për vizita (60117 x 3 =180351 ore pune) dhe plani i kontrollave(1012 x 93 = 94116 orë punë) në total i bie 180351 + 94116=274467.


Realizimi i kontrollave 967 x 102 = 98881,realizimi i vizitave 58285 x 1.25 = 72856 orë pune në total 172078 orë pune. Nga plani totali orëve efektive 274467 – 171737 të realizuara,na del një diferenc 102730 orë pune.Nga rezultatet e të dhënave shihet se nuk është shfrytëzuar mirë koha e punës me çka mund të themi se nuk është menaxhuar mirë koha si nga ana e pronjësve ashtu edhe e menaxherëve.Ka munguar një angazhim por edhe një mbikqyrje më e rrept dhe ma profesionale nga menaxherët.

Tabela 5. Plani i vizitave dhe kontrollave dhe realizimi i tyre të shprehura orë pune

	Plani	Realizimi	diferenca
Nr. I vizitave	60117	58285	-1832
Orët efektive	3	1.15	-1.45
Gjithsejt orë vizita	180351	72856	-107495
Nr i kontrollave	1012	967	-45
Orët për kontroll	93	102	9
Gjithsejt orë kontroll	94116	98881	4765
Totali orëve efektive	274467	171737	102730

Burimi: ATK, Përpunuar nga autori

PARAQITJA GRAFIKE E TABELËS NR.5



Burimi:ATK,Përpunuar nga autori

Nga tabela e mësipërme shohim se kemi një menaxhim jo efektiv të kohës sepse nga totali i orëve të planifikuara 274467 orë pune janë të arsyetuara janë 171737 orë pune dhe kemi 102730 orë të humbura. Shiqar në përqindje kemi kohë e shfrytëzuar 62 % dhe kohë të humbur 38 %.Duke e parë specifikën e punës që bëhet në ATK deri diku të arsyetohet sepse ka shumë punë që nuk janë të matshme por gjithsesi ka një dallim të madh në mes të orëve të planifikuara dhe atyre të realizuar.

Kjo kohë e humbur mund të ketë ndikim negativ në performansen e ATK-së.Nga intervistat që kam bërë me të punësuarit se shiqar nga këndi i tyre për të arritur performans më të lartë dhe për të menaxhuar kohën kërkesa e tyre është që të rritet pavarësia,barabarësia në ndarjen e punëve,drejtësia,lavdata kur ka vend për to,përkrahja në punë dhe në fund vlerësimi real i performanses së tyre.Të gjitha këto kërkesa duhet t'i kenë parasysh menaxherët e të gjitha niveleve dhe duhet të ndërmerren hapa konkret për planifikimin dhe për realizimin e tyre.

Sa i përketë burimeve të brendshme të organizatës siq janë:aftësitë profesionale të punonjësve,paisjët kapitale dhe aftësitë e menaxherëve mund të themi se janë elemente që na qartësojnë se këto burime ATK-ja i ka por është shumë kompleks që këto burime të koordinohen.Në ngritjen profesionale ATK-ja ka investuar me anë të trajnimeve si në kuadër të ATK-së ashtu edhe jashtë saj.Edhe në planin vjetor janë të parapara mesatarisht 6 ditë pune për trajnime.Pajimet kapitale që i posedon janë në niveline kënaqshëm.

Për stafin menaxhues janë organizuar trajnime shtesë lidhur me menaxhimin dhe se efektet e tyre janë parë si në shfrytëzimin e kohës së punës ashtu edhe në menaxhimin e stafit.

Një element shumë i rëndësishëm i lidhur me burimet e brendshme është problemi i motivimit të të punësuarëve.Nga intervistat që kam bërë problemi i motivimit është problemi kryesor edhe pse ka lëvizje të vogël të koeficientit të pagave apo të themi simbolike,kjo paraqet një pengesë për rritje të performanses.Motivuesit të tjerë siq janë kushtet e punës,komunikimi mirë,trajtimi i barabartë,lavdatat,mirënjohjet janë në nivelin e kënaqshëm.

Kapacitetet mbështeten në aftësitë unike të punonjësve.Njohuria e poseduar nga kapitali njerëzor është ndër aftësitë më të rëndësishme të organizatës dhe mund të jetë burimi i të gjitha avantazheve konkurruese(Menaxhimi strategjik,(B. Musabelliu,D.Kërçini,2012)prandaj ATK-ja duhet të jetë në gjendje t'i njoh dhe t'i përdori ato aftësi të të punësuarëve të tyre.

Kompetencat bazë ndërtohen nga dy element.Elemneti i parë ka të bëjë me katër kritere specifike dhe elementi i dytë analiza e zingjirit të vlerës.

Kriteret për avantazh konkures siq janë:i vlefshëm,i rrallë,i kushtueshëm të imitohet dhe i pazëvendësueshëm.Kjo ka të bëjë me aspektin e burimeve njerëzore sepse ATK-ja duhet të ndërtojë një staf të pregaditur që të ketë integritet por që të gjejë forma që atë staf ta mbajë në kuadër të saj e për këtë problemi i motivimit të tyre vie në shprehje.

Analiza e zingjirit të vlerës në ATK ka të bëjë me atë se për të ardhur deri te të hyrat për buxhetin e Kosovës kryesisht bazohet në burimet e veta por specifika e saj bënë që ajo të jetë e lidhur me institucionet tjera për të arritur qëllimin e vet.

Mund të konkludojmë se në përgjithëse ka nevojë për burime njerzore shtesë dhe të gjindet forma për motivimin e të punësuarëve që është kusht për menaxhimin e kohës.

Nga sa u tha më lartë mund të konstatojë që hipoteza e ngritur se faktorët e mjedisit të brendshëm janë të lidhura pozitivisht me performansesn menaxheriale dhe të punësuarëve në ATK sepse kanë ndikim pozitiv në menaxhimin e kohës.Sa më shumë të shfrytzojmë burimet e brendshme,aftësitë e të punësuarëve dhe kompetencat bazë aq më mirë do të menaxhohet koha duke e ndërlidhur gjithsesi me motivimin që është një kusht i rëndësishëm.

5. Konkluzione/ Rekomandime

Nga të gjeturat nga të dhënat empirike dhe nga intervistimet e të punësuarve dhe menaxherëve mund të nxjerrim këto konkluzione si më poshtë.

Administra Tatimore e Kosovës si agjension që funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës se Kosovës ka një planë strategjik nga i cili janë nxjerr planet vjetore për realizimin e objektivave të veta dhe misionit të vet që është ofrimi i shërbimeve cilësore për tatimpaguesit,si dhe përmbushja e obligimeve të tatimpaguesëve ndaj detyrimeve tatimore.

Në planin vjetor për vitin 2014 janë precizuar sa ditë pune dhe sa orë pune efektive ka për të punësuarit e saj.Fokusi i këtij punimi është departamenti i operacioneve që është numerikisht më i madhi dhe më i rëndësishmi sepse përmes këtij departamenti realizohet e hyra.

Koha në dispozicion është 274467 orë pune efektive për 253 inspektorë që i bie 1085 orë për një inspektor.Ky është një planifikim shumë real sepse janë hequr ditët e vikendeve,pushimeve,festave,ditë e planifikuara për trajnim dhe janë planifikuar 217 ditë mesatarisht për një inspektor.Nga ditët e punës është marrur 5 orë efektive(217 x 5 = 1085)

Me plan operativ janë përcaktuar se duhet të kryhen në të gjitha regjionet 60117 vizita dhe koha e ndarë për një vizitë është 3 orë (60117 x 3 = 180351 orë punë) dhe janë planifikuar 1012 kontrolla dhe koha e ndarë për kontroll është 93 orë pune (1012 x 93 = 94116 orë pune).

Nga analiza e bërë e orëve të realizuara që gjithsejt janë 171737 që do të thotë se nuk është shfrytëzuar koha e punës efektive,pra nuk kemi një menaxhim të mirë të kohës së punës.Nga intervistat e të punësuarëve dhe menaxherëve arsyeja e mos shfrytëzimit të kohës janë mjaftë kompleks duke filluar nga motivimi,mbajtja e takimeve të gjata dhe në disa raste të panevojshme,ndërhyrja me kërkesa të ndryshme ditore që dalin jashtë planit operativ,ngarkesa me formalitete të tepërta,mosdelegimi me kohë i detyrave,problem paraqitet informatat kthyesë që kjo ka të bëjë me komunikimin,ndikimi i ndryshimeve në legjislacion,praktika e kryerjes së punëve në përfundim të afatit etj.

Të gjitha këto barriera kanë ndikimin e vet në menaxhimin e kohës por sipas mendim tim informata kthyesë,motivimi kryesisht në paga dhe monitorimi janë faktorët kryesor për menaxhim të dobët të kohës.Mungesa e sinergjisë ku njerzit e duhur nuk janë në vendin e duhur edhe kjo është një faktorë që ndikon në menaxhimin e jo efikas të kohës ë punës.

Në përgjithësi menaxhimi i kohës i ka edhe sfidat e veta. Duke e pasur parasysh specifikën e institucionit të analizuar e cila ka kufizime në ndryshimin e legjislacionit,pamundësisë së lëvizjes së shpejtë dhe marrjes së shpejtë të vendimeve më poshtë po jap rekomandimet e mia.

Pasi Administrata Tatimore e Kosovës ka një plan të detajuar për menaxhimin e kohës nga ana e të punësuarëve duhet të bëhet analiza e punës në afate kohore si ditor,javore,mujore,tremujore dhe gjashtëmujore dhe të jenë vetkritik dhe të gjejnë arsyen për mosrealizimin e detyrave të punës.

Percaktimi i vlerave vetanake dhe të kuptojnë se çka është e rëndësishme për të punësuarit.T'i parashtrajnë pyetje vetvetes,përse punojnë në atë institucion,përse janë duke e bërë atë që janë duke e bërë.Pra duhet përcaktuar synimin e tyre lidhur me qëndrimin e tyre në organizatë.

Për të menaxhuar kohën së pari duhet të kihen parasysh katër,,D”.D-ja e parë ka të bëjë me dëshirën për ta pasur nën kontroll kohën,D-ja e dytë është deqiziviteti apo vendosmëria për të praktikuar teknikat e menaxhimit të kohës,D-ja e tretë është determinimi apo këmbëngulja që për çfardo lloj joshje mos të hiqet dorë nga vendimet e marra,dhe D-ja e katërt disiplina.për të arritur suksesin menaxhimin e kohës duhet shëndrruar në një lloj praktike të përjetëshme(Brian Tracy,2014).

Identifikimi dhe prioritetizimi i qëllimeve,duke i ranguar dhe grupizuar në nivele prioritetet në ato shumë të rëndësishme,më pak të rëndësishme dhe ato të dorës së dytë të cilat duhet të injorohen.

Pranimi i direktivave të qarta,kuptimi i detyrave që duhet kryer.

Delegimi i detyrave me kohë dhe tek personat që mund ta kryejnë atë punë,të kihet kujdes që mos të delegohen detyrat tek personat që nuk mund ta kryejnë atë punë.

Eliminimi i takimeve të parëndësishme që e shpenzojnë kohën kot dhe zvogëlimi i shpenzimit joproduktiv të kohës së punës siq janë aktivitetet shoqërore,kerkimi i gjërave të parëndësishme të cilat mund të evitohen me një organizim më të mirë të vendit të punës,shmangja e personave të cilët janë të dhënë të bëjnë spjegime të gjata dhe që flasin shumë.

Mbajtja e shënimeve për punët që duhet bërë dhe në fund të orarit analiza e detyrave të realizuara,të shiqohet se ku ka ngecje dhe më këtë duhet bërë përmirësime në ditët në vazhdim.

Heqja e praktikës së lënies së punëve për më vonë.Mund të ndodh që që detyrat që i kemi lënë për më vonë mund të jenë detyra me prioritet të lartë.

Vendosja e rutinës,pra e një programi nga fillimi i ditës së punës deri në fund të orarit dhe të vendosën një rregullë për punës gjatë orarit të punës.

Gjetja e vazhdueshmërisë,në rast se organizimi i një dite apo një jave rezulton e sukseshme,atëherë organizimi i javës së ardhme të mbështetet tek java e mbyllur me sukses.Gjithmonë është ide e mirë që të ngriten themelet e diçkaje mbi t ëcilën sukseesi është provuar.

Paraqitja si realist në përcaktimin e datës së fundit të dorëzimit të ndonjë detyre dhe këtë ta bëjnë jo nga forca e detyrimit por realizimi të bëhet sipas planit sigurisht që është më profesional dhe më pak stresues.

Bibliografia

Administrata Tatimore e Kosovës,(2014)Plani vjetor,Raporti vjetor i punës,Prishtinë Zeqiri,I.(2006),Menaxhmenti,Tetovë,botimi i parë
Musabelliu,B.Kërçini,D.Bejko,A.(2012), Menaxhimi strategjik,Tiranë Tracy,B.
(2014),Menaxhimi i kohës, përktheu Aleksandër Koli,Prishtinë

Burime nga interneti:

Fisher,F.(2001),Upravljanje sopstvenim vremenom,www.fpd.l.ro.
<http://skeja.me/2013/05/14/menaxhimi-i-kohës/> Menaxhimi i kohës,(2013). <http://menaxhim.com/>
2011/11/08/rreth-menaxhimit-te-kohes/ Rreth menaxhimit të kohës,(2011)
<http://manager.hr/Ucinkovito-upravljanje-vremenom>(2009).

MENAXHIMI I ZINXHIRIT TË FURNIZIMIT. NJË RAST STUDIMOR KRAHASIMOR

DENISA MAMILLO, DOKTORANTE

Asistente Pedagoge pranë Departamentit të Menaxhimit dhe Ekonomiksit

Universiteti Europian i Tiranës.

E-mail: denisa.mamillo@uet.edu.al

ABSTRAKT

Nëse firmat më parë bënë gjithçka vetë, sot disa funksione duhet ti performojnë kompanitë e tjera. Performanca e firmës varet kryesisht nga performanca e partnerëve të zinxhirit. Ky ndryshim shpjegon rritjen e nivelit të angazhimit të shumë kompanive në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit pas viteve 1980. Megjithëse interesi në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit është rritur, pothuajse asnjë kërkim nuk është bërë në Shqipëri. Qëllimi i këtij punimi është të analizojë arsyet dhe nivelin e angazhimit në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit të prodhuesve kryesorë shqiptarë të birrës dhe kompanive kryesore të përpunimit të qumështit. Metodologjia e përdorur është intervista me menaxherët kryesorë të kompanive, objekt studimi. Një pyetësor gjysëm i strukturuar është përgatitur. Pyetësi fokusohet në tre pjesë kryesore: arsyet e angazhimit në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, kriteret për përzgjedhjen e partnerëve të zinxhirit të furnizimit dhe niveli i angazhimit në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit. Ky studim do të tregojë që prodhuesit shqiptarë të birrës dhe kompanitë e përpunimit të qumështit i njohin avantazhet e menaxhimit të zinxhirit të furnizimit, por kostot janë shumë të larta për të justifikuar një nivel të lartë angazhimi në këtë nismë. Hapi i parë i menaxhimit të zinxhirit të furnizimit është zgjedhja e partnerëve. Kriteret kryesore për përzgjedhjen e partnerëve janë kostot, besueshmëria dhe sinergia për prodhuesit e birrës, kurse për kompanitë e përpunimit të qumështit kriteret kryesore janë sinergia, cilësia dhe besueshmëria. Niveli i angazhimit në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit është më i lartë për kompanitë e përpunimit të qumështit krahasuar me prodhuesit e birrës. Një nga kufizimet kryesore të këtij punimi është fokusimi në kompaninë prodhuese dhe jo në të gjitha kompanitë e zinxhirit të furnizimit.

Fjalë kyç: Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit, prodhues birre, përpunues qumështi, partnerë

1. Hyrje

Interesi në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit u rrit pas vitit 1980, pasi në atë kohë shumë pak kompani ishin vertikalisht të integruara. Këto kompani kuptuan që nuk mund të fitonin avantazh kompetitiv vetëm, por duhet të bashkëpunonin me furnitorët dhe klientët. Një tjetër arsye është sensibilizimi i firmave për avantazhet që vijnë si pasojë e angazhimit në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, ku mund të përmendim: përmirësimin e investimeve, ulje të nivelit të stokut në magazinë (Boyer & Stock, 2009), rritje të kënaqësisë së klientëve dhe furnitorëve (Myers, 2010), përmirësimin e shitjeve dhe kuotës së tregut (Myers & Cheung, 2008) dhe shumë avantazhe të tjera.

Megjithatë interesi për menaxhimin e zinxhirit të furnizimit është rritur, pothuajse asnjë kërkim nuk është bërë në Shqipëri. Kjo është arsyeja kryesore pse zgjedha të bëj këtë kërkim.

Qëllimi i këtij studimi është analizimi i arsyeve dhe nivelit të angazhimit në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit të prodhuesve kryesorë shqiptarë të birrës dhe kompanive kryesore të përpunimit të qumështit. Arsyet pse zgjedha këto dy industri janë:

Industria e birrës dhe industria e përpunimit të qumështit janë dy nga industritë më të rëndësishme në Shqipëri.

Ekzistojnë pesë prodhues birre të mëdhenj në një vend të vogël si Shqipëria, dhe pothuajse të gjithë po përjetojnë një rritje të shitjeve dhe fitimeve. Për këtë arsye kjo industri do të ishte një rast interesant për tu studiuar.

Këto dy industri janë më të prekura nga problemet e zinxhirit të furnizimit sidomos industria e përpunimit të qumështit ku cilësia e lëndës së parë është e rëndësishme.

Artikulli është organizuar në këtë mënyrë: Pas hyrjes, do të jetë seksioni i rishikimit të literaturës për menaxhimin e zinxhirit të furnizimit. Më pas do të shpjegohet metodologjia e përdorur dhe të dhënat do të analizohen. Seksioni i fundit do të diskutojë kufizimet e studimit dhe rekomandimet për menaxherët dhe studimet e ardhshme.

2. Rishikimi i literaturës

Zinxhiri i furnizimit dhe menaxhimi i zinxhirit të furnizimit janë dy konceptet kryesore në këtë punim, prandaj një përkufizim duhet të jepet.

2.1 Përkufizime

Zinxhiri i furnizimit përfshin të gjitha aktivitetet në lidhje me zhvendosjen e të mirave dhe shërbimeve nga faza e marrjes së lëndës së parë deri në fazën e blerjes së produktit nga klienti, (Christopher, 2010). Sipas përkufizimit tradicional, menaxhimi i zinxhirit të furnizimit lidhet me sigurimin e lëndës së parë me kosto shumë të ulët. Bazuar në këtë këndvështrim firmat duhet të kenë shumë furnitorë. Konkurrenca midis tyre do të zgjedhë më të mirin bazuar në kosto dhe performancë. Pra bashkëpunimi nuk është i rëndësishëm, pasi lidhjet me furnitorët nuk janë afatgjata (Spekman et al., 1998).

Por gjërat kanë ndryshuar. Sipas Christopher (2010) sot kompanitë e kanë të qartë se bashkëpunimi me anëtarët e zinxhirit të furnizimit mund të ndihmojë në krijimin e një avantazhi kompetitiv të qëndrueshëm. Kalimi nga një mjedis biznesi të qëndrueshëm në një mjedis më dinamik dhe të paparashikueshëm, kërkon bashkëpunim me të gjithë partnerët, për të arritur rezultatin më të mirë për secilin. Për këto arsye një përkufizim i ri i menaxhimit të furnizimit duhet ofruar. Përkufizimi që do të përdoret në këtë artikull është: Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit lidhet me menaxhimin e marrëdhënieve me të gjithë anëtarët e zinxhirit, në mënyrë që të përfitohet vlerë më e lartë me kosto më të ulët (Christopher, 2010). Sipas këtij përkufizimi, fokusi i menaxhimit të zinxhirit të furnizimit është bashkëpunimi me të gjithë anëtarët e zinxhirit, që të arrihet rezultati më i mirë për të gjithë.

2.2 Angazhimi në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit

Duke u bazuar në kërkimet e autorëve të ndryshëm (Sheffi, 2007; Walker, Sisto, & Mc Bain, 2008; Pagell & Hu, 2009; Carter Easton, 2011; Revilla & Saenz, 2014) mund të listoj arsyet kryesore të angazhimit të firmave në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit. Arsyeja kryesore e angazhimit në këtë nismë është rritja e fitimeve, pasi bashkëpunimi rrit kënaqësinë e klientëve dhe furnitorëve. Klientët të kënaqur do të thotë më shumë shitje dhe besnikëri. Furnitorët të kënaqur do të thotë sigurimi i lëndës së parë në kohë, duke siguruar vazhdimësinë e procesit të prodhimit dhe sa më pak kosto të mbajtjes së lëndës së parë në magazinë.

Një arsye tjetër është dhe përmirësimi i produktivitetit dhe lehtësia e futjes së produkteve të reja në treg. Gjithashtu bashkëpunimi me anëtarët e zinxhirit të furnizimit mund të bëhet për arsye mjedisore, politike dhe taksash. Këto arsye vlejnë më shumë në vendet në zhvillim. Një firmë mund të zgjedhë të bashkëpunojë me disa furnitorë dhe klientë për të përfutuar nga ligjet e vendit në lidhje me taksat. Për arsye politike disa firma mund të kenë më shumë avantazhe, prandaj do të ishte mirë ti kishe pjesë të zinxhirit të furnizimit. Kohët e fundit mbrojtja e mjedisit është kthyer në një çështje kritike. Arritja e standarteve mjedisore mund të jetë më e lehtë nëse të gjithë anëtarët e zinxhirit bashkëpunojnë për të përmbushur këto standarte.

Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit kërkon bashkëpunim, i cili është më i lehtë kur ke partnerët e duhur, kështu që një aspekt i rëndësishëm është dhe zgjedhja e partnerëve të zinxhirit të furnizimit. Kriteret që firmat përdorin për zgjedhjen e partnerëve të zinxhirit përfshijnë reputacionin, cilësinë e produkteve, performanca financiare dhe eksperiencën e kaluar e bashkëpunimit me këto kompani (Duffy, 2014). Normalisht kriteret për seleksionim e partnerëve në zinxhirin e furnizimit ndryshojnë nga industria në industri, por kriteret si përfitime mjedisore, përfitime ekonomike dhe niveli i sinergjisë midis firmave janë kriteret kryesore që vlejshëm pothuajse për çdo industri.

Pas përzgjedhjes së partnerëve hapi tjetër është përcaktimi i nivelit të angazhimit në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit. Koperimi është hapi i parë i menaxhimit të zinxhirit të furnizimit. Firmat që koprojnë kanë pak furnitorë dhe kontrata afatgjatë me furnitorët dhe klientët (Stadtler, 2014). Por koperimi nuk është i mjaftueshëm, prandaj hapi tjetër është kordinimi, ku anëtarët e zinxhirit shkëmbejnë informacione në kohë reale midis tyre për të lehtësuar kordinimin e aktiviteteve të ndryshme (Arshinder, Kanda, & Deshmukh, 2008). Niveli më i lartë i angazhimit është bashkëpunimi, bazuar në përkushtim dhe besim midis partnerëve. Në këtë fazë kompanitë shkëmbejnë informacione të plota midis tyre, ndajnë vizione të përbashkëta për të ardhmen dhe marrin vendime bashkarisht (Whipple & Russell, 2007).

3. Metodologjia e punimit

Intervista gjysëm të strukturuar u zhvilluan me menaxherët e kompanive të përzgjedhura. Nga pesë kompanitë kryesore të birrës vetëm katër pranuan të jepnin informacion, kurse nga nëntë kompanitë kryesore të përpunimit të qumështit vetëm shtatë kompani u bënë pjesë e këtij studimi.

Pyetësi përmbante tre pjesë kryesore, Pjesa e parë lidhej me arsyet e angazhimit në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit. Një listë arsyesh ishte përmendur bazuar nga literatura. Të intervistuarit mund të përmendnin dhe arsye të tjera. Pjesa e dytë kërkonte të përmendeshin kriteret e përdorur për përzgjedhjen e partnerëve të zinxhirit të furnizimit. Njësoj si në pjesën e parë një listë kriteresh bazuar te literatura ishin përmendur, por ishte lënë dhe hapësirë për kriteret të tjera që s'ishin përmendur në pyetësor. Pjesa e fundit përmbante pyetje të hapura për të përcaktuar nivelin e angazhimit në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit. Një nivel i ulët angazhimi lidhet me fazën e koperimit, kurse një nivel i lartë angazhimi lidhet me fazën e bashkëpunimit (të përmendura te rishikimi i literaturës).

Pyetësi u vlerësua nga akademikët dhe gjithashtu u testua te një nga kompanitë prodhuese të birrës. Pas testimit vetëm pak ndryshime u bënë në lidhje me terminologjinë e përdorur.

Çështjet etike më të rëndësishme në këtë kërkim ishin konfidencialiteti i të dhënave, shmangja e pyetjeve kritike, mosrepektimi i të intervistuarit, kërkimi i konsensusit për publikimin e rezultateve të kërkimit dhe premtimi për të dërguar një kopje të konkluzioneve të kërkimit menaxherëve.

4. Analiza e të dhënave

4.1 Arsyet e angazhimit në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit

Të dhënat nga përgjigjet e pyetësorit për pjesën e parë janë përmbledhur në Tabelën 1.

TABELA 1: ARSYET E ANGAZHIMIT NË MENAXHIMIN E ZINXHIRIT TË FURNIZIMIT

Prodhuesit e birrës		Kompanitë e përpunimit të qumështit	
<i>Më të rëndësishmet</i>	<i>Më pak të rëndësishmet</i>	<i>Më të rëndësishmet</i>	<i>Më pak të rëndësishmet</i>
1. Rritja e shitjeve	1. Arsyet politike	1. Sigurimi i furnitorëve	1. Arsyet politike
2. Ulja e kostove	2. Arsyet taksash	të besueshëm	2. Arsyet taksash
3. Rritja e kënaqësisë së klientëve	3. Përmirësim produktiviteti	2. Rritja e kënaqësisë së klientëve	3. Arsyet mjedisore
		3. Rritje fitimesh	

Në tabelë janë paraqitur tre arsyet më të rëndësishme dhe më pak të rëndësishme për tu angazhuar në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit për prodhuesit shqiptarë të birrës dhe kompanitë shqiptare të përpunimit të qumështit.

Vihet re që asnjë nga kompanitë nuk do të përpiqej të rriste nivelin e angazhimit në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit për arsye politike ose taksash. Ndoshta këto janë arsye delikate prandaj janë stepur të tregohen të sinqertë për këtë pikë.

Prodhuesit shqiptarë të birrës mendojnë se angazhimi në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit do të ishte i nevojshëm për të rritur fitimet dhe kënaqësinë e klientëve, ku arsyeja e parë mbizotëron. Kompanitë e përpunimit të qumështit deklarojnë se angazhimi në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit do të ishte i nevojshëm kryesisht për të rritur kënaqësinë e klientëve dhe për të siguruar furnitorë të rregullt dhe të besueshëm.

Analiza e përgjigjeve për pjesën e parë të pyetësorit tregon se prodhuesit e birrës ndryshe nga kompanitë e përpunimit të qumështit fokusohen në aspektin financiar të përfitimeve nga menaxhimi i zinxhirit të furnizimit. Fitimi qëndron mbi kënaqësinë e klientit. Furnitorët, sidomos ata të qumështit, janë shumë të rëndësishëm për kompanitë e përpunimit të qumështit. Cilësia e lëndës së parë përcakton dhe cilësinë e produktit final, prandaj është e rëndësishme të kesh furnitorë të besueshëm që ofrojnë lëndë të pare të cilësisë së lartë.

4.2 Përzgjedhja e partnerëve të zinxhirit të furnizimit

Në tabelën 2 janë paraqitur tre kriteret më të rëndësishme dhe më pak të rëndësishme për të përzgjedhur partnerët e zinxhirit të furnizimit për prodhuesit shqiptarë të birrës dhe kompanitë shqiptare të përpunimit të qumështit.

TABELA 2 : KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E PARTNERËVE TË ZINXHIRIT TË FURNIZIMIT

Prodhuesit e birrës		Kompanitë e përpunimit të qumështit	
<i>Më të rëndësishmet</i>	<i>Më pak të rëndësishmet</i>	<i>Më të rëndësishmet</i>	<i>Më pak të rëndësishmet</i>
1. Besueshmëria	1. Ofron avantazhe mjedisore	1. Besueshmëria	1. Ofron avantazhe politike
2. Ndhmon në uljen e kostove	2. Ofron avantazhe politike	2. Cilësia e produktit	2. Ofron avantazhe mjedisore
3. Ekzistenca e sinergjisë	3. Ofron avantazhe në taksë	3. Ekzistenca e sinergjisë	3. Ofron avantazhe në taksë

Si prodhuesit shqiptarë të birrës dhe kompanitë e përpunimit të qumështit nuk zgjedhin si partnerë të zinxhirit të furnizimit ata që ofrojnë avantazhe politike, taksash ose mjedisore. Këto përgjigje përputhen dhe me rezultatet e pjesës së parë. Për të gjitha kompanitë e rëndësishme është që partneri të jetë i besueshëm dhe të ekzistojë sinergji dhe mirëkuptim midis tyre. Kompanitë e përpunimit të qumështit theksojnë edhe aspektin e cilësisë së produktit të ofruar nga firmat e tjera si një kriter i rëndësishëm partneriteti. Prodhuesit e birrës do të favorizonin bashkëpunimin me partnerë që ndihmojnë në uljen e kostove.

4.3 Niveli i angazhimit në zinxhirin e furnizimit

Prodhuesit shqiptarë të birrës për një lloj të caktuar produkti kanë shumë pak furnitorë. Në disa raste ata kanë furnitorë të përbashkët me konkurrentët. Me furnitorët strategjikë duhet të bashkëpunosh vazhdimisht dhe të ndërtohet marrëdhënie të mira, por kjo gjë nuk vihet re në këtë industri. Kompanitë e birrës nënshkruajnë kontrata aftagjata me furnitorët dhe kanë pak furnitorë. Ata nuk preferojnë të shkëmbejnë informacione as me furnitorët as me klientët. Ata nuk përdorin software për të shkëmbyer informacione me shitësit me pakicë, të paktën për gjendjen e stokut në dyqan dhe magazinë. Menaxherët pohojnë se klientët e tyre nuk janë mësuar të përdorin programe për shkëmbimin e informacionit dhe kultura shqiptare është restriktive në natyrë, prandaj ata e kanë të vështirë të japin informacione të detajuara për biznesin e tyre. Duke u bazuar në këto të dhëna mund të konkludoj se prodhuesit shqiptarë të birrës janë te faza e parë (koperimi) e angazhimit në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit.

Kompanitë e përpunimit të qumështit janë në fazën e dytë (kordinimi) të angazhimit në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit. Ndryshe nga prodhuesit e birrës ato bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë më shumë informacion me furnitorët, sidomos ata të qumështit. Menaxherët e kompanive të përpunimit të qumështit pohuan se është shumë e rëndësishme që të kenë informacion të plotë për aktivitetet e furnitorëve të tyre sidomos për ata që përket kontrollit të cilësisë të qumështit. Disa kompani bashkëpunojnë me pikat e grumbullimit të qumështit dhe shkëmbejnë vazhdimisht informacione. Ata kanë nënshkruar kontrata aftagjata, por në raste vështirësisht ndihmojnë furnitorët. Menaxherët kanë deklaruar se shumica e problemeve të zinxhirit të furnizimit lidhen kryesisht me furnitorët e qumështit, prandaj kordinimi i aktiviteteve midis tyre dhe bashkëpunimi është i rëndësishëm.

Pra kompanitë e përpunimit të qumështit kanë një nivel më të lartë angazhimi në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit.

5. Konkluzione

Kompanitë shqiptare të prodhimit të birrës dhe ato të përpunimit të qumështit i njohin dhe i pranojnë përfitimet e angazhimit në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, por kostot janë shumë të larta për ta justifikuar investimin në një nismë të tillë. Problemi kryesor është edukimi i partnerëve të fundit të zinxhirit të furnizimit (klientët) për të bashkëpunuar dhe shkëmbyer informacion. Prodhuesit e birrës do të vendosnin të rrisnin angazhimin e tyre në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit për të rritur fitimet kurse kompanitë e përpunimit të qumështit kryesisht për të siguruar cilësinë dhe vazhdimësinë e furnizimit me lëndë të parë.

Kompanitë e përpunimit të qumështit kanë një nivel më të lartë angazhimi në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit krahasuar me prodhuesit e birrës. Sipas tyre të gjithë anëtarët e zinxhirit të furnizimit janë kritikë për rritjen e fitimeve dhe kënaqësisë së të gjithëve. Kjo është arsyeja që kriteri kryesor për përzgjedhjen e partnerëve të zinxhirit të furnizimit është besueshmëria dhe sinergia jo kostot. Kjo arsye e fundit vlen për prodhuesit e birrës.

6. Rekomandime për menaxherët

Bazuar në rezultatet e këtij kërkimi, rekomandimet e mia për menaxherët janë:

Ne po jetojmë në një botë të pasigurt, dhe është më mirë të kesh disa furnitorë për të njëjtin produkt. Nëse diçka i ndodh njërit, prodhimi nuk ndalet pasi ke furnitorin tjetër. Disa kompani zgjedhin të kenë vetëm një furnitor. Kjo strategji ka më pak kosto dhe është më e lehtë të ndërtohet marrëdhënie të mira me furnitorët. Furnitorë të kënaqur do të thotë më shumë cilësi dhe stabilitet të furnizimit me lëndë të parë. Nga ana tjetër duke patur shumë furnitorë ka shumë kosto dhe është e vështirë të ndërtohet marrëdhënie të mira me gjithsecilin, por të paktën siguron vazhdimësinë e prodhimit nëse një problem i ndodh një furnitori. Para se të verndosësh të kesh një ose më shumë furnitorë për një produkt të caktuar, analizo mjedisin e jashtëm. Nëse ndan të njëjtin furnitor me konkurrentët është e rëndësishme të bashkëpunosh me të, pra një nivel i lartë angazhimi në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit kërkohet.

Bashkëpunimi me të gjithë partnerët e zinxhirit të furnizimit është i nevojshëm për të analizuar dhe gjetur rrënjën e problemit. Sot zinxhirët e furnizimit janë shumë vulnerabël, nëse diçka i ndodh klientëve, furnitorëve ose distributorëve, edhe firma do ti vuajë efektet e këtij problemi. Duke bashkëpunuar do të kesh informacion për çdo gjë që ndodh dhe madje mund ta shmangësh problemin para se të ndodhë. Bashkëpunimi është i nevojshëm në kohë normale dhe në kohë krizash.

Niveli i angazhimit në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit varet nga industria. Në disa industri niveli i pasigurisë është i lartë, prandaj më shumë bashkëpunim duhet, kurse disa industri kanë nivel të ulët pasigurie prandaj koperimi mjafton, pa kaluar te faza e bashkëpunimit.

Menaxherët e kompanive duhet të mendojnë në aftagjatë dhe jo në aftashkurtër. Kostot janë të rëndësishme, dhe dihet që angazhimi në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit kërkon kohë dhe para. Por përfitimet financiare dhe jofinanciare nga angazhimi në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit janë të shumta dhe i justifikojnë humbjet fillestare.

7. Kufizimet e punimet dhe rekomandime për kërkime të mëtejshme

Kufizimi kryesor i këtij punimi është fokusi në firmën prodhuese. Kërkimi do të ishte më i plotë nëse do të intervistoheshin dhe partnerët e tjerë të zinxhirit të furnizimit.

Studimet e mëtejshme duhet ta konsiderojnë kufizimin e këtij punimi. Ky studim mund të kryhet dhe në industri të tjera për të parë nëse rezultatet janë të ndryshme për të gjitha industritë apo ka ngjashmëri midis disa industrive.

Një rekomandim tjetër për kërkimet e ardhshme do të ishte analizimi i nivelit të pasigurisë në zinxhirin e furnizimit dhe lidhja e kësaj niveli pasigurie me nivelin e angazhimit në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit.

Bibliografia

- Arshinder, K., Kanda, A., & Deshmukh, S. (2008). A Review on Supply Chain Coordination: Coordination Mechanisms, Managing Uncertainty and Research Directions. *International Journal of Production and Economics*, 115(2), 316-335.
- Boyer, S. & Stock, S., 2009. Developing a consensus definition of supply chain management: a qualitative study. *International Journal of Physical Distribution & Logistics Management*, 39(8): 690-711.
- Carter, C., & Easton, L. (2011). Sustainable supply chain management: evolution and future directions. *International Journal of Physical Distribution & Logistics Management*, 41(1), 46-62.
- Christopher, M., 2010. *Logistics and supply chain management*. New Jersey: Financial Time Management.
- Duffy, R., 2014. The future of purchasing and supply: supply chain partner selection and contribution. [Online] Available at: <http://www.ism.ws/pubs/content.cfm?itemnumber=9722> [Accessed on 30 June 2014].
- Myers, M. B., 2010. The many benefits of supply chain collaboration. *Supply Chain Management Review*.
- Myers, M. B. & Cheung, S., 2010. Sharing global supply chain knowledge. *Sloan Management Review*, 49.
- Pagell, M., & Hu, Z. (2009). Building a more complete theory of sustainable supply chain management using case studies of 10 exemplars. *Journal of Supply Chain Management*, 45(2), 37-56.
- Sheffi, Y., 2007. *The resilient enterprise: Overcoming vulnerability for competitive advantage*. Cambridge, Massachusetts: The MIT Press.
- Spekman, R. E., Kamauff Jr, J. W. & Mhyr, N., 1998. An empirical investigation into supply chain management. A perspective on partnerships. *Supply Chain Management*, 3(2): 630-650
- Revilla, E., & Saenz, M. J. (2014). Supply chain disruption management: Global convergence vs national specificity. *Journal of Business Research*, 67(6), 1123-1135.
- Stadler, H. (2014). *Supply chain management: an overview*. Berlin: Springer Berlin Heidelberg.
- Walker, E., Sisto, L., & Mc Bain, D. (2008). Drivers and barriers to environmental supply chain management practices: Lessons from the public and private sectors. *Journal of purchasing and Supply Chain Management*, 14(1), 69-85.
- Whipple, J. & Rusell, D., 2007. Building supply chain collaboration: a typology of collaborative approaches. *International Journal of Logistics Management* 18(2): 174-197.

NDIKIKIMI I KULTURËS KOMBËTARE NË NIVELIN E BASHKËPUNIMIT NË ZINXHIRIN E FURNIZIMIT

DENISA MAMILLO, DOKTORANTE

Asistente Pedagoge pranë Departamentit të Menaxhimit dhe Ekonomiksit
Universiteti European i Tiranës.
E-mail: denisa.mamillo@uet.edu.al

PROF. ASOC. OLTJANA ZOTO

Shefe e Departamentit të Menaxhimit dhe Ekonomiksit
Universiteti European i Tiranës
E-mail: oltjana.zoto@uet.edu.al

ABSTRAKT

Sot kompanitë po përballen me një pasiguri më të madhe në kërkesë, furnizim dhe teknologji. Kompanitë përdorin strategji të ndryshme për të ulur pasigurinë, si për shembull rritja e fleksibilitetit të zinxhirit të furnizimit, mbajtja e rezervave strategjike, dizanji modular etj. Të gjitha këto strategji kërkojnë bashkëpunim dhe kordinim. Por bashkëpunimi nuk është gjithmonë i lehtë, pasi shumë faktorë ndikojnë në suksesin e bashkëpunimit. Në këtë studim do të studiohet ndikimi i faktorit kulturë kombëtare dhe pasiguri në nivelin e bashkëpunimit me partnerët e zinxhirit të furnizimit. Studimi është fokusuar në industrinë e birrës, dhe kryesisht te kompanitë kryesore të prodhimit të birrës në Shqipëri. Metodologjia e përdorur është intervista me menaxherët kryesorë të kompanive objekt studimi. Një pyetësor gjysëm i strukturuar është përgatitur. Pyetësi fokusohet në dy pjesë kryesore: pasiguria dhe niveli i bashkëpunimi me partnerët e zinxhirit të furnizimit. Studimi do të tregojë se bashkëpunimi në industrinë e birrës është në nivele mesatare, duke ju referuar indeksit të bashkëpunimit. Një bashkëpunim i efektshëm, kërkon ndarje informacioni, besim reciprok, përkushtim, punë grupi dhe konsensus. Kultura shqiptare përfshin disa prej këtyre elementëve, por jo të gjitha. Kjo shpjegon nivelin mesatar të bashkëpunimit me partnerët e zinxhirit. Ky studim është i pari që analizon efektin e kulturës kombëtare në nivelin e bashkëpunimit me partnerët e zinxhirit të furnizimit. Rezultatet e këtij studimi mund të jenë shumë të rëndësishme jo vetëm për menaxherët në industrinë e birrës por edhe në industri të tjera.

Fjalë kyç: *Bashkëpunim, prodhues birre, pasiguri, kulturë kombëtare*

1. Hyrje

Kompanitë po përballen me një pasiguri më të madhe në zinxhirin e furnizimit. Shkaqet kryesore të kësaj pasigurie janë klientët, teknologjia dhe furnitorët (Chen&Paulraj, 2003). Si pasojë e globalizimit dhe rritjes së përdorimit të internetit, klientët sot kërkojnë shumëllojshmëri mallrash me çmime më të ulëta dhe cilësi më të mirë. Këto ndryshime e bëjnë të vështirë parashikimin e kërkesës për produktet dhe shërbimet e kompanive. Teknologjia ndryshon shpejt, dhe nëse nuk kap në kohë trendet e fundit teknologjike mund të humbasësh avantazhin kompetitiv. Dhe së fundi, firmat kanë shumë furnitorë në vende të ndryshme, pasi distanca nuk është më një problem. Menaxhimi i një rrjeti global furnitorësh është më i vështirë, dhe pasiguria lidhur me korrektesën dhe cilësinë është më e lartë se sa kur ke vetëm furnitorë lokalë.

Një pasiguri e lartë në zinxhirin e furnizimit do të thotë kosto më të larta, vështirësi për futjen e produkteve të reja në treg dhe pakënaqësi për anëtarët e zinxhirit të furnizimit. Për këto arsye ulja e pasigurisë është shumë e rëndësishme. Firmat përdorin strategji të ndryshme për të ulur pasigurinë si psh rritja e fleksibilitetit të zinxhirit të furnizimit (Lee,2004), dizanji modular, mbajtja e rezervave strategjike (Tang,2006), rritja e resiliencës së zinxhirit të furnizimit (Sheffi,2007), etj. Të gjitha këto strategji kërkojnë bashkëpunim me anëtarët e zinxhirit të furnizimit. Shumë kompani pranojnë se suksesi i tyre vjen si pasojë e bashkëpunimit me furnitorët dhe klientët.

Bashkëpunimi është i nevojshëm për të ulur pasigurinë, por jo të gjitha firmat arrijnë të bashkëpunojnë me sukses. Bashkëpunimi kërkon ndarje informacioni, sinkronizim vendimesh, përkushtim, besim, respekt etj (Laskowska- Rutkowska, 2009). Disa kultura kombëtare i kanë të pranishëm këto elementë prandaj bashkëpunimi mund të jetë më i thjeshtë.

2. Qëllimi dhe hipotezat e punimit

Qëllimi i këtij punimi është analizimi i efektit të pasigurisë dhe kulturës kombëtare në nivelin e bashkëpunimit me anëtarët e zinxhirit të furnizimit. Punimi është fokusuar në industrinë e birrës, pasi ajo është një industri e rëndësishme në Shqipëri dhe gjithashtu dhe një industri ndryshe nga të tjerat pasi ekzistojnë pesë prodhues birre të mëdhenj në një vend të vogël si Shqipëria, dhe pothuajse të gjithë po përjetojnë një rritje të shitjeve dhe fitimeve.

Duke u bazuar në diskutimin e seksionit të mësipërm, sugjeroj hipotezat e mëposhtme:

H1: Me rritjen e pasigurisë dhe niveli e bashkëpunimit me anëtarët e zinxhirit të furnizimit rritet.

H2: Kulturat kombëtare individualiste dhe jo risk dashëse vështirësojnë procesin e bashkëpunimit.

Artikulli është organizuar në këtë mënyrë: Pas hyrjes, do të jetë seksioni i rishikimit të literaturës. Më pas do të shpjegohet metodologjia e përdorur dhe të dhënat do të analizohen. Seksioni i fundit do të diskutojë konkluzionet, kufizimet e studimit dhe rekomandimet për menaxherët dhe studimet e ardhshme.

3. Rishikimi i literaturës

3.1 Pasiguria e zinxhirit të furnizimit

Zinxhiri i furnizimit i shumë kompanive po përballen me një pasiguri më të madhe. Shkaqet e kësaj pasigurie janë të shumta ku mund të përmendim krizën globale të 2008, zhvillimi teknologjik dhe rritja e vulnerabilitetit të zinxhirit të furnizimit.

Kriza globale rriti burimet e pasigurisë së zinxhirit të furnizimit. Ne mund të përmendim shkaqe të tilla si: tregëti e paqëndrueshme, risku i shkëmbimit të huaj, pasiguri për rregullat dhe ligjet, pasiguri për zgjedhjen e furnitorëve nga vendet e zhvilluara etj. (Malik & Ruwadi, 2014).

Zhvillimet e fundit teknologjike po rrisin nivelin e pasigurisë. Teknologjia ndryshon shpejt, dhe kompanitë duhet të jenë inovative, në mënyrë që të fusin në treg produkte të reja. Meqënëse produktet e reja futen shpesh në treg, firmat duhet të mbajnë pak stok në magazinë. Për të arritur këtë firmat përdorin praktikata e “just in time inventory management”, duke rritur nivelin e pasigurisë në zinxhirin e furnizimit.

Sot kompanitë nuk janë më të integruara vertikalisht dhe zinxhiri i tyre i furnizimit është global. Një zinxhir furnizimi global është më i vështirë për tu menaxhuar dhe më vulnerabël (Wagner & Bode, 2007).

Lancaster, Simangusong dhe Lancaster (2011) argumentojnë se shkaqet kryesore të pasigurisë në zinxhirin e furnizimit mund të grupohen në tre kategori: pasiguri që vjen nga kompania prodhuese, pasiguri që vjen nga anëtarët e zinxhirit të furnizimit dhe pasiguri që lidhet me ndikimin e faktorëve jashtë zinxhirit të furnizimit. Ky punim fokusohet në kategorinë e dytë të pasigurisë.

Chen dhe Paulraj (2003) ia atribuojnë arsyen e kësaj kategorie të pasigurisë klientëve, furnitorëve dhe teknologjisë. Pasiguria e furnitorëve lidhet me korrektesinë dhe cilësinë e lëndës së parë ose produkteve të ofruara. Pasiguria e kërkesës i referohet variacioneve të paparashikuara në kërkesë dhe pasiguria teknologjike lidhet me ritmin e zhvillimit teknologjik.

Pasiguria i kushton shumë firmës, prandaj duhen hartuar strategji për ta reduktuar nivelin e pasigurisë në zinxhirin e furnizimit. Strategjitë mund të jenë të ndryshme (përmendur te seksioni i hyrjes) por e rëndësishme është që secila strategji të kesh lëndën e parë në magazinë në momentin kur të duhet, pra të mbash pothuajse zero produkte në magazinë.

kërkon bashkëpunim me anëtarët e zinxhirit të furnizimit për të qënë e sukseshme. Seksioni tjetër do të trajtojë pikërisht bashkëpunimin dhe rolin e tij në uljen e pasigurisë në zinxhirin e furnizimit.

3.2 Bashkëpunimi në zinxhirin e furnizimit

Bashkëpunimi i sjell shumë përfitime kompanisë, ku më kryesoret janë përmirësim i efektivitetit, efikasitetit dhe kënaqësisë së klientit (Myers, 2010); përmirësim i kuotës së tregut dhe fitimeve (Myers & Cheung, 2010), përmirësim në inovacion (Sheffi, 2007) etj. Lind pyetja pse firmat nuk bashkëpunojnë me anëtarët e zinxhirit të furnizimit kur kjo është fitimprurëse për të gjithë? Arsyeja është vështirësia e bashkëpunimit.

Bashkëpunimi është i thjeshtë kur ke partnerët e duhur, kështu që një aspekt i rëndësishëm i bashkëpunimit është seleksionimi i partnerëve të zinxhirit të furnizimit. Sipas Barrat (2004) bashkëpunimi kërkon të ndash objektivat e kompanisë me partnerët, besim, respekt dhe përkushtim në mënyrë që të gjithë të përfitojnë. Këta faktorë konsiderohen nga firmat kur selektojnë partnerët me të cilët duan të bashkëpunojnë, por nuk janë të vetmit. Faktorë të tjerë përfshijnë performancën financiare të partnerëve, reputacionin, eksperiencën e mëparshme dhe nivelin e ekzistues të sinergjisë (Duffy, 2014).

Pas zgjedhjes së partnerëve të duhur, hapi tjetër është zgjedhja e elementëve të bashkëpunimit. Shumë e konsiderojnë procesin e bashkëpunimit në zinxhirin e furnizimit si unilateral, pra i fokusuar vetëm në një element. Simatupang dhe Sridharan (2005) argumentojnë se elementët kryesorë të bashkëpunimit ndërveprojnë midis tyre. Sipas tyre këta elementë përfshijnë ndarje informacioni, sinkronizim vendimesh dhe ndarje përfitimesh dhe kostosh. Ndarje informacioni i referohet aksesit në të dhënat personale të partnerëve. Sinkronizim vendimesh do të thotë kordinimi i vendimeve kritike. Bazuar në këto tre elementë autorët zhvilluan indeksin e bashkëpunimit, i cili do të përdoret në këtë kërkim për të matur nivelin e bashkëpunimit.

Bashkëpunimi ndihmon kordinimin e kërkesës me planin e prodhimit të furnitorëve dhe firmës prodhuese, duke ulur pasigurinë e kërkesës dhe furnizimit (McLaren, Head & Yuan, 2005). Bashkëpunimi me anëtarë e zinxhirit të furnizimit mund të ulë dhe pasigurinë që vjen nga teknologjia, pasi shkëmbimi i informacioneve në kohë reale ndihmon në kapjen e trendeve teknologjike më shpejt. Pra bashkëpunimi ndihmon në uljen e pasigurisë në zinxhirin e furnizimit.

Bashkëpunimi është i nevojshëm për të ulur pasigurinë, por jo gjithmonë i sukseshëm. Bashkëpunimi kërkon ndarje informacioni, sinkronizim vendimesh, përkushtim, besim, respekt etj (Laskowska- Rutkowska, 2009). Disa kultura kombëtare i kanë të pranishëm këto elementë prandaj bashkëpunimi mund të jetë më i thjeshtë. Seksioni tjetër do të trajtojë kulturën kombëtare.

3.3 Kultura kombëtare

Për të analizuar kulturën kombëtare do të përdoret studimi i Hofstede (2010). Sipas autorit gjashtë elementët kryesorë të një kulture janë: distanca nga pushteti, individualizmi, maskulizmi, shmangia e pasigurisë, orientimi afatgjatë dhe indulgenca.

Distanca nga pushteti i referohet faktit se sa anëtarët më pak të fuqishëm të një shoqërie pranojnë që pushteti nuk është shpërndarë në mënyrë të barabartë. Anëtarët e shoqërive individualiste shohin vetëm interesin e tyre dhe të familjes kurse anëtarët e shoqërive kolektiviste vlerësojnë besnikërinë ndaj grupit të cilit i përkasin. Shoqëritë me nivel të lartë maskulizmi janë të orientuara drejt arritjeve personale dhe janë konkurruese, kurse shoqëritë

që pëlqejnë shmangjen e pasigurisë orientohen drejt planifikimit. Indulgenca i referohet nivelit të kontrollit të dëshirave dhe impulseve nga ana e anëtarëve të shoqërisë.

Distanca nga pushteti është shumë e lartë në Shqipëri, prandaj strukturat organizative të kompanive janë kryesisht hierarkike. Kultura shqiptare është maskuliste dhe kolektiviste. Shqiptarët janë të orientuar drejt arritjeve personale dhe ngritjes në detyrë. Ata nuk pëlqejnë punën në grup, pasi sipas tyre puna në grup nuk vlerëson tamam performancën e tyre. Kultura shqiptare paraqet një nivel të lartë indulgence, që do të thotë se njerëzit nuk i shprehin lirisht dëshirat e tyre dhe tentojnë të jenë pesimistë. Dhe së fundmi, kultura shqiptare nuk është risk dashëse dhe i jep një rëndësi të veçantë planifikimit.

Pra, kultura shqiptare nuk i jep shumë rëndësi bashkëpunimit, pasi është individualiste dhe parapëlqen të bazohet te planifikimi sesa te bashkëpunimi për uljen e pasigurisë.

4. Metodologjia

Metodologjia e përdorur është intervista gjysëm të strukturuar me menaxherët e kompanive kryesore prodhuese të birrës në Shqipëri. Nga pesë kompanitë vetëm katër u bënë pjesë e studimit, pasi menaxherët e një kompanie nuk pranuan të japin informacione për temën e kërkimit. Menaxherët e intervistuar ishin menaxherë shitjesh, prokurimesh dhe në një rast pronari i biznesit. Të gjitha intervistat u zhvilluan personalisht, dhe anonimiteti i datave u premtua.

Një pyetësor u përgatit për të suportuar intervistat. Pyetësori kishte dy pjesë kryesore. Pjesa e parë kishte si synim matjen e nivelit të pasigurisë në zinxhirin e furnizimit. Siç u përmend te rishikimi i literaturës, shkaqet kryesore të pasigurisë janë kërkesa, furnitorët dhe teknologjia (Chen and Paulraj, 2003). Për secilin shkak autorët paraqitën një listë pyetjesh të shkallës Likert nga 1 në 5, ku 1= nuk jam aspak dakort dhe 5= jam pothuajse dakort. Duke mbledhur pikët totale mund të llogarisim nivelin e pasigurisë së kërkesës, pasigurisë së furnizimit dhe pasigurisë teknologjike. Nivelin total të pasigurisë të zinxhirit të

furnizimit është shuma e tre pasigurive të sipërpërmendura.

Pjesa e dytë e pyetësorit synonte matjen e nivelit të bashkëpunimit me anëtarët e zinxhirit të furnizimit. Sipas Simatupang dhe Sridharan (2005) dimensionet e bashkëpunimit janë ndarja e informacionit, sinkronizim vendimesh dhe ndarje kostosh dhe përfitimesh. Për secilin dimension një listë pyetjesh janë paraqitur të shkallës Likert nga 1 në 5, ku 1= nuk jam aspak dakort dhe 5= jam pothuajse dakort. Indeksi i bashkëpunimit është shuma e pikëve për secilin dimension.

Pyetësori u vlerësua nga akademikët dhe gjithashtu u testua te një nga kompanitë prodhuese të birrës. Pas testimit vetëm pak ndryshime u bënë në lidhje me terminologjinë e përdorur.

Çështjet etike më të rëndësishme në këtë kërkim ishin konfidencialiteti i të dhënave, shmangja e pyetjeve kritike, mosrepektimi i të intervistuarit, kërkimi i konsensusit për publikimin e rezultateve të kërkimit dhe premtimi për ti dërguar një kopje të konkluzioneve të kërkimit menaxherëve.

5. Analiza e të dhënave

Tabela 1 paraqet rezultatet për matjen e nivelit të pasigurisë në zinxhirin e furnizimit.

TABELA 1: NIVELI I PASIGURISË

	<i>Pasiguria nga kërkesa</i>	<i>Pasiguria nga furnitorët</i>	<i>Pasiguria teknologjike</i>	<i>Niveli i pasigurisë në zinxhirin e furnizimit</i>
Pikët	52	14	43	109
Pikët maksimale	100	40	80	220
Vlerësimi i nivelit të pasigurisë	Mesatar	I ulët	Mesatar	Mesatar

Niveli i pasigurisë si total dhe nëndimensionet janë llogaritur duke mbledhur vlerësimet e të intervistuarve nga pyetësori. Pikët maksimale lidhen me vlerësimin 5 për çdo pyetje shumëzuar me numrin e të intervistuarve. Duke krahasuar vlerësimin nga pyetësorët me pikët maksimale, mund të vlerësohet nëse niveli i pasigurisë është i lartë, mesatar apo i ulët.

Rezultatet tregojnë se niveli i pasigurisë së zinxhirit të furnizimit është në nivele mesatare për prodhuesit shqiptarë të birrës. Nëse analizojmë nëndimensionet, ata deklarojnë se furnitorët janë të besueshëm dhe ofrojnë produkte të një cilësie të mirë dhe konstante. E njëjta gjë nuk mund të thuhet për teknologjinë dhe kërkesën. Prodhuesit shqiptarë pranojnë se ka variacione në kërkesë, por që mund të menaxhohen duke mbajtur rezerva në magazinë. Meqë ka shumë konkurrencë është e nevojshme të kapësh trendet e fundit teknologjike, që të jesh një hap para konkurrencës.

Tabela 2 paraqet rezultatet për indeksin e bashkëpunimit. Niveli i bashkëpunimit dhe nëndimensionet e tij janë llogaritur duke mbledhur vlerësimet e të intervistuarve nga pyetësori. Pikët maksimale lidhen me vlerësimin 5 për çdo pyetje shumëzuar me numrin e të intervistuarve. Duke krahasuar vlerësimin nga pyetësorët me pikët maksimale, mund të vlerësohet nëse niveli i bashkëpunimit është i lartë, mesatar apo i ulët.

TABELA 2: NIVELI I BASHKËPUNIMIT

	<i>Ndarje informacioni</i>	<i>Sinkronizim vendimesh</i>	<i>Ndarje kostosh dhe përfitimesh</i>	<i>Indeksi i bashkëpunimit</i>
Pikët	108	95	56	259
Pikët maksimale	200	160	100	460
Vlerësimi i nivelit të bashkëpunimit	Mesatar	Mesatar	Mesatar	Mesatar

Edhe rezultati i indeksit të bashkëpunimit është në nivele mesatare. Prodhuesit shqiptarë të birrës nuk parapëlqejnë të ndajnë çdo informacion dhe të dhëna me anëtarët e zinxhirit të furnizimit. Ata nuk e konsiderojnë shumë të nevojshme pjesëmarrjen e anëtarëve të zinxhirit të furnizimit kur merren vendime për parashikimin e shitjeve, stokut në magazinë dhe promocioneve. Disa kompani sinkronizojnë vendimet me klientët kryesorë por jo me furnitorët, pasi në shumë raste ndajnë të njëjtët furnitorë me konkurrentët. Prodhuesit shqiptarë të birrës ndajnë kostot dhe përfitimet me anëtarët që kanë ndihmuar në arritjen e rezultateve të mira.

6. Konkluzione

Në përgjithësi niveli i bashkëpunimit të prodhuesve shqiptarë me anëtarët e zinxhirit të furnizimit është në nivele mesatare. Arsyja kryesore është mungesa e vullnetit për të shkëmbyer informacion me partnerët. Prodhuesit shqiptarë të birrës mendojnë se sinkronizimi i vendimmarrjes dhe ndarja e kostos dhe përfitimeve mund të jetë fitimprurëse për gjithsecilin në zinxhirin e furnizimit.

Mjedisi i ri i biznesit po përballë me një pasiguri më të lartë, e cila mund të atribuohet pasigurisë që rrjedh nga kërkesa, furnitorët dhe teknologjia. Arsyeja kryesore e pasigurisë për prodhuesit shqiptarë të birrës është pasiguria nga kërkesa, kurse pasiguria nga ana e furnitorëve është e ulët. Furnitorët gjithmonë përmbushin kërkesat dhe ofrojnë material të cilësisë konstante. Rezultatet e këtij studimi treguan se prodhuesit shqiptarë të birrës po përballen me një nivel pasigurie mesatar në zinxhirin e furnizimit. Ky rezultat shpjegon dhe nivelin mesatar të bashkëpunimit. Pra hipoteza e parë e punimit qëndron.

Hipoteza e dytë e punimit pohon se kulturat kombëtare individualiste dhe jo risk dashëse vështirësojnë procesin e bashkëpunimit. Kultura shqiptare është individualiste dhe me nivel të lartë të shmangies së pasigurisë, kurse niveli i bashkëpunimit është në nivele mesatare. Prodhuesit shqiptarë të birrës pranojnë se më shumë bashkëpunim duhet pasiguria po vjen duke u rritur, por problemi është se nuk janë mësuar të bashkëpunojnë. “Kultura jonë dhe mënyra si jemi rritur na kufizon”- deklaroi një menaxher. Pra edhe hipoteza e dytë e punimit qëndron.

Ky studim tregoi se niveli i bashkëpunimit me anëtarët e zinxhirit të furnizimit në industrinë shqiptare të birrës varet nga niveli i pasigurisë dhe kultura kombëtare. Jo të gjitha kulturat lehtësojnë procesin e bashkëpunimit. Kulturat individualiste dhe jo risk dashëse e vështirësojnë bashkëpunimin në zinxhirin e furnizimit.

7. Rekomandime dhe kufizime

Pothuajse asnjë studim nuk është bërë për bashkëpunimin me anëtarët e zinxhirit të furnizimit në Shqipëri, prandaj mendoj se vlera e këtij punimi është e rëndësishme sidomos për menaxherët e kompanive. Në bazë të rezultateve të këtij kërkimi u sugjeroj menaxherëve:

Analizo mjedisin e jashtëm para se të veprësh: Niveli i bashkëpunimit varet nga niveli i pasigurisë. Analizo fillimisht nivelin dhe arsyet e pasigurisë dhe më pas vendos nivelin e bashkëpunimit, pasi ky proces kërkon kohë dhe para.

Analizo oportunitetet dhe kërcënimet që vijnë nga kultura kombëtare: Kompanitë kanë kultura të ndryshme organizative. Shumë elementë të kulturës së tyre të brendshme ndikohen nga kultura kombëtare, prandaj është mirë të jesh i vetëdijshëm për kufizimet dhe mundësitë që të jep kultura e vendit në botën e biznesit.

Bashkëpunimi që të rritësh kontrollin mbi zinxhirin e furnizimit: Sot zinxhirët e furnizimit të shumë kompanive janë kompleksë dhe globalë. Nëse një pjesë e zinxhirit është e dobët, gjithë pjesët e tjera do e ndjejnë këtë mangësi. Mënyra më e mirë për të zbuluar dhe kontrolluar pikët e dobëta është ndarja e vazhdueshme e informacioneve, pra bashkëpunim. Kjo duhet bërë në kohë normale dhe sidomos në kohë krizash.

Kufizimi kryesor i këtij punimi është fokusi në firmën prodhuese. Kërkimi do të ishte më i plotë nëse do të intervistoheshin dhe partnerët e tjerë të zinxhirit të furnizimit.

Studimet e mëtejshme duhet ta konsiderojnë kufizimin e këtij punimi. Ky studim mund të kryhet dhe në industri të tjera për të parë nëse rezultatet janë të ndryshme për të gjitha industritë apo ka ngjashmëri midis disa industrive.

Bibliografia

- Chen, I. J., & Paulraj, A. (2003). Towards a theory of supply chain management: the constructs and measurements. *Journal of Operations Management*, 22, 119-150.
- Duffy, R. (2014, June 30). The future of purchasing and supply: supply chain partner selection and contribution. Retrieved from Institute of Supply Chain Management: <http://www.ism.ws/pubs/content.cfm?itemnumber=9722>
- Hofstede, G., Hofstede, G. J., & Minkov, M. (2010, June 2). *Cultures and organizations*. Mc- Graw Hill.
- Lancaster, H. L., Simangusong, E., & Lacanster, S. M. (2011). Supply Chain Uncertainty: A Review and Theoretical Foundation for Future Research. *International Journal of Production Research*.
- Laskowska-Rutkowska, A. (2009). The impact of national and organizational culture. *Journal of Intercultural Management*, 1(2), 5-16.
- Lee, H. L. (2004, October). The triple A supply chain. *Harvard Business Review*, f. 6.
- Malik, Y., & Ruwadi, B. (2014, June 14). Building the supply chain of the future. Retrieved from Mc Kinsey & Company: http://www.mckinsey.com/insights/operations/building_the_supply_chain_of_the_future
- Mc Laren, T. S., Head, M., & Yuan, Y. (2005). Costs and benefits in supply chain collaboration. Në E. Li, & T. C. Du, *Advances in electronic business*, Volume 1, 258-284. Idea Group Pub.
- Myers, M. B. (2010). The many benefits of supply chain collaboration. *Supply Chain Management Review*.
- Myers, M. B., & Cheung, S. (2010). Sharing global supply chain knowledge. *Sloan Management Review*, 49.
- Sheffi, Y. (2007). *The resilient enterprise: Overcoming vulnerability for competitive advantage*. Cambridge, Massachusetts: The MIT Press.
- Simatupang, T., & Sridharan, R. (2005). The collaboration index: a measure for supply chain collaboration. *International Journal of Physical Distribution & Logistics Management*, 35(1), 44-62.
- Tang, C. S. (2006). Robust strategies for handling supply chain disruptions. *International Journal of Logistics*, fv. 33-45. Wagner, S. M., & Bode, C. (2007). An empirical investigation into supply chain vulnerability. *Journal of Purchasing & Supply Management*, 301-312.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E NDËRMARRJEVE PRODHUESE NË KOMUNËN E PEJËS

SYLË KOLICA, PHD(C)

Universiteti evropian i Tiranës, Fakulteti ekonomik, Profili –

Menaxhim email: S.kolica@hotmail.com

ABSTRAKT

Pas luftës së fundit në Kosovë misioni i qeverisjes lokale është që të rritet pjesëmarrja e ndërmarrjeve prodhuese në rritjen ekonomike të komunës së Pejës në krahasim me sferat tjera. (Remitencat, Tregtia dhe Turizmi). Teoria bazë ku mbështetet ky punim është specifikimi dhe fokusimi në variabla që jep mundësi për të shpjeguar dhe përshkruar standartin jetësor të qytetarëve të Pejës dhe përshkruan botën reale të tyre duke i lidhur konceptet në teori që kanë implikime empirike. Korelacioni në mes të koncepteve sjell ndryshim sepse egziston një lidhje në mes faktorit A që është rritja dhe qëndrueshmëria e këtyre ndërmarrjeve dhe faktorit B që kjo rritje dhe qëndrueshmëri ndryshon mirëqënien sociale të qytetarëve të Pejës. Qenia pro-biznes përben kushtin themelor për të qënë pro-social. Të vetëdijshëm për domosdoshmërinë e pajtimit të politikave sociale me tregun e lirë.

Përgjegjësia sociale e ndërmarrjeve prodhuese përkufizohet si shoqëri e fortë konsumi, liberalizim i tregut të punës, pjesëmarrje aktive të këtyre ndërmarrjeve në procesin e globalizimit si dhe promovimi i “ekonomisë së dijes”.

Ndërmarrjet prodhuese në komunën e Pejës, në kohën e sotme e cilësuar si periudhë e liberalizimit janë në hapat e parë të kuptuarit se ekonomia e tyre ka qëllim vënien e saj në shërbim të njerëzve duke pasur parasysh tregun dhe efektivitetin e shtetit minimal.

Pra shteti në rastin konkret qeveria lokale duhet të krijojë ambient të përshtatshëm për frymëmarrje të lirë të këtyre ndërmarrjeve të cilat janë opsion i vetëm për rritje ekonomike të komunës së Pejës dhe zvogëlim të varfërisë.

Fjalë kyç: *Përgjegjësia sociale, Qeverisja lokale, Rritja dhe qëndrueshmëria, Ekonomia e dijes*

Hyrje

Vendi ynë pra komuna e Pejës është relativisht e varfër, me ekonomi problematike në rajon prandaj dalja nga kjo situatë do të ndikoj në rritjen e mirëqënies sociale të kësaj komune. Sintagma se pa prodhim nuk ka zhvillim ekonomik na shtyen të mendojm më seriozisht se qeveria komunale duhet të krijoj ambient të përshtatshëm për të krijuar kushte që këto ndërmarrje prodhuese të rriten dhe të jene të qëndrueshme për të gjetur tregje të reja pasi të plotësohen nevojat vetanake për konsum. Shpenzimet e ushqimit janë barr e rënde për popullatën e kësaj komune, prandaj importi i këtyre produkteve duhet të zvogëlohet dhe të zëvendësohet me prodhime vendore. Një hap të tillë sidomos pas luftimeve e kanë ndjekur kompanitë më të njohura në komunën e Pejës sic është kompania Devolli, ELKOS group, Bibita, Vokshi commerce, TAKA, Dardania, dhe fabrika e birrës pas ndërrimit të titullarit të tij. Ka shenja të rritjes së punësimit dhe të ardhurave familjare nga këto ndërmarrje prodhuese në komunën e Pejës. Grumbullimi i lëndës së parë sic është qumështi, gruri dhe produktet tjera bujqësore dhe ato të mishit kanë mundur përveq numrit të punëtorëve aktiv edhe punësime sekondare. Komunën e Pejës e karakterizon pozita e përshtatshme gjeografike e cila mundëson që të kemi një lëndë të parë vetanake për zhvillimin e industrisë ushqimore. Kjo industri në Pejë ka egzistuar që nga vitet e 70-ta, do të thotë para luftës si zonë industriale në juglindje të qytetit të Pejës në një lartësi mbidetare prej 432 metra, afër njëjës hekurudhore Fushë Kosovë – Pejë dhe magjistrale Pejë – Prishtinë. Prandaj me të drejt mund të thuhet se konfiguracioni gjeografik i komunës së Pejës është në favor të zhvillimit të ndërmarrjeve prodhuese që direkt ndikojnë në rritje ekonomike dhe mirëqënie sociale të qytetarëve të Pejës. Shikuar zhvillimi historik të ndërmarrjeve prodhuese të komunës së Pejës dhe duke krahasuar këto ndërmarrje me ato në rajon shihet se ka një dallim të madh në kontestin historik- kohor. Kjo distancë kohore nuk mund të bëhet fjalë për vite por për dekada dhe shekuj. Ngase krijimi i zonës industriale në Pejë daton që nga vitet e 70-ta duke filluar me fabrikën e birrës në Pejë e cila në fillim u ndihmua nga një fabrikë e njejtë nga Gjermania. Sikurse komunat tjera të Kosovës ashtu edhe komunën e Pejës e mundon si sfidë papunësia e theksuar, prandaj pasluftën në Kosovë disa biznesmen kanë filluar të kuptojnë se ekonominë e vogla familjare duhet tu jepet prioritet për zhvillim që të zgjidhet problemi i papunësisë dhe të rriten të ardhurat familjare, e tërë kjo për të realizuar fitime mbi mesataren dhe krijuar mirëqënie sociale. Pas luftimeve ndërmarrjet prodhuese të mëparshme përveq fabrikës së birrës e cila e filloj menjëher aktivitetin ekonomik, të tjerat u shkatërruan dhe me procesin e privatizimit për shkakë të teknologjive të vjetra ato e ndërruan destinacionin.

Ndërmarrjet prodhuese në këtë komunë ende bartin barrën e investimeve fillestare dhe të njejtat ende nuk kanë arritur stadin që rritja ekonomike dhe mirëqënia sociale të rrjedhë nga këto ndërmarrje. Kjo thuhet për arsye se numri i madh i punësuarve është në ndërmarrjet tregtare të cilat importojnë mall nga rajoni shumica e të cilëve mund të prodhohet edhe në komunën tonë. Prandaj rritja ekonomike e komunës së Pejës dhe mirëqënia sociale e saj në tërësi nuk mund të paramendohet pa prodhim ashtu sic është në rajon dhe më gjerë. Mentaliteti i menaxhmentit të këtyre ndërmarrjeve është drejtuar kah bujqësia si burim i lëndës së parë të prodhimeve të tyre strategjike sic është qumështi Vita, mielli, dhe produkte të mishit në përgjithësi përgjithësia sociale dhe punësimet sekondare nga këto ndërmarrje prodhuese shpjegohen në aspektin e marrëdhënieve të këtyre ndërmarrjeve me grupet e interesit – kooperantët. (pikat e grumbullimit të qumështit në rastin e parë, dhe pikat e grumbullimit të grurit në rastin e dytë.). Kjo është tendenca e këtyre ndërmarrjeve që produktet ushqimore të importuara të zëvendësohen me produkte vendore sepse ky regjion ka kushtë të vulltshme për zhvillimin e kësaj industrie e cila në veçanti kjo komunë ka zonë industriale.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi I studimit është për të gjetur dhe kuptuar ndërlidhjet që dalin nga konkurentët e këtyre ndërmarrjeve prodhuese dhe mundësia për të formuar inteligjencë konkurruese. Të kuptuarit e konkurrencës vjen nga të dhënat dhe informacionet që këto ndërmarrje marrin për konkurentët e tyre. Një qëllim tjetër është edhe gjetja e mundësisë për të krijuar avantazh konkurrues dhe të ngulitet në kokat e menaxherëve të këtyre ndërmarrjeve se përveq fitimit kanë edhe përgjithësinë sociale.

Treguesit e zhvillimit ekonomik të komunës së Pejës kanë ndikim të rëndësishëm në stabilitetin ekonomik të kësaj komune dhe ndikimi i këtyre ndërmarrjeve prodhuese ka objektivat e veta.

Rritja ekonomike që kërkon ngritje kapacitetesh për të rritur produktin vendor në këtë komunë dhe më gjerë.

Ulja e papunësisë 8-10 % me influencë në nivel vendi, sepse papunësia është problem i vazhdueshëm që përcjell komunën tonë që nga paslufta. Synimi për një ulje të papunësisë duke rritur prodhimin nga këto ndërmarrje nga kjo komunë është plan ambicioz që parashihet në planet afat-mesme dhe afat gjata të komunës sonë.

Revitalizimi i bujqësisë, pasi Peja ka strukturë rurale, një revitalizim të këtij sektori do të ndikoj ndjeshëm në zbutjen e papunësisë dhe mirëqënies sociale si dhe zvogëlimin e importeve të produkteve bujqësore për të cilat një sasi e madhe e mjeteve monetare derdhen jashtë vendit për importin e këtyre produkteve.

Ndërmarrjet prodhuese në komunën e Pejës janë duke kaluar në kohën e cilësuar si “Periudha e liberalizimit” dhe filozofisë së shtetit “laissez-faire”, që do të thotë se ekonomia nuk duhet të kishte qëllim tjetër veq vënies se saj në shërbim të njëzve, pra ekonomia përpos tjerash, fitimit është si një instrument në zhvillimin social¹(J.M KEYNES) . Laissez-faire funksionon në këto ndërmarrje mbi bazën e ligjit të ofertës dhe kërkeses, i cili e rregullon vetvetiu jetën ekonomike të shoqërisë.

¹ Dilemat e zhvillimit, A.Civici. Tiranë, 2007.

Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Pyetje kërkimore

- Sa është pjesëmarrja e ndërmarrjeve prodhuese në mirëqënien sociale të komunës së Pejës në krahasim me sferat tjera. (Remitentat, Tregtia dhe turizmi).
- Sa është krijuar intelegjencë në mentalitetin e menaxhmentit të këtyre ndërmarrjeve për tu drejtuar kah bujqësia si burim i lëndës së parë për prodhime strategjike.
- Cilat janë problematikat që vërehen si pengesë për investitorët e huaj.

Mobilizimi i kursimit të diasporës nga kjo komunë dhe remitencat nga bashkëqytetarët tanë në botën e jashtme është ndihmesë e fuqishme për mirëqënien sociale të qytetarëve të Pejës. Ristrukturimi i ekonomisë dhe rritja e investimeve në infrastrukturë ishin prioritetet të ngutshme për strukturat udhëheqëse në Pejë dhe pasluftës. Donacionet e shumta në rindërtimin e këtij qyteti të shkatërruar plotësisht nga lufta dhe në ekonominë familjare janë hapat e parë të ecjes së ekonomisë së kësaj komune kah stabiliteti. Roli i diasporës është teper i madh për këtë komunë e cila mobilizon konsumin dhe ka pjesëmarrje në privatizim të ndërmarrjeve prodhuese pasluftë në këtë komunë. Pra remitencat konsiderohen si të parët në renditje për rritje ekonomike dhe mirëqënie sociale në komunën e Pejës. Këto nga shumë biznesmen shqiptaro-amerikan janë kthyer në investime të drejtpërdrejta përmes procesit të privatizimit pas vitit 2000 të disa ndërmarrjeve të rëndësishme prodhuese të cilat tani kryejn aktivitetin e tyre ekonomik me titullar të ri. Nevoja për mbijetesë dhe investime më të vogla ka bërë që në këtë komunë sikurse në Kosovë në përgjithësi të hapen shumë biznese të vogla dhe të mesme tregtare e turistike. Me këtë deri në vitet e fundit² Fuqia e diasporës dhe ndërmarrjet tregtare e turistike renditen para atyre prodhuese.

Ndërmarrjet prodhuese një pjesë e madhe e tyre planifikon dhe i vë vetes detyrë se lënda e parë mund të sigurohet nga fermerët në komunë dhe jasht saj. Ato organizojnë bartjen dhe transportin e kësaj lënde të parë në tërë territorin e rrafshit të Dukagjinit dhe më gjërë. Në vendet në rajon zakonisht kjo lëndë e parë sic është qumështi, gruri dhe misri subvencionohet nga shteti ngase është artikull jetik. Grumbullimi i kësaj lënde të parë nga prodhuesit e qumështit, miellit dhe produkteve të mishit si dhe perimeve në tërësi zbut nivelin e papunësisë dhe ka ndikuar tërthorazi sidomos në vitet e fundit në mirëqënien sociale të qytetarëve të kësaj komune. Subvencionet nga qeveria qendrore dhe ajo lokale në vitet e fundit edhe pse ende të vogla kanë shtuar interesimin e shumë fermerëve për prodhimtari më të lartë. Janë një mori faktorësh të jashtëm që po ndikojnë negativisht në planifikimin e lëndës së parë nga këto ndërmarrje prodhuese.


- Tregu jo i kontrolluar sa duhet (Ligjet e tregut të lirë janë të cenuara)
- Mos efikasiteti i doganës.
- Politika jo e mirë fiskale (Pagesa e TVSH-së fikse në doganë).
- Konkurrenca jo lojale .
- Kualiteti dhe qmimet e dyshimta në treg.

Me këtë qeveria e Kosovës duhet të mendojë që të ndaj më shumë nga buxheti i Kosovës për sektorin e bujqësisë i cili do të stimulonte fermerët tanë që të shtojnë numrin e bagëtive ndërsa bujqit të mbjellin më shumë kultura gruri dhe misri sepse komuna e Pejës ashtu sikurse Kosova në tërësi është shoqëri konsumi.

Instituti ekonomik RINVEST ka studiuar mirë pengesat kryesore me të cilat ballafaqohen investitorët e huaj ato fillojnë nga furnizimi jo i mirë me rrymë elektrike, infrastruktura ligjore e mangët me korrupsion të lartë mungesa e garantimit të investimeve, telekomunikimet, mungesa e përvojës në IJD jo stabiliteti politik, tregu i kufizuar, veriu i Kosovës dhe rezultata 12/44 i këshillit të sigurimit.

Ndërmarrjet prodhuese në këtë komunë në aspektin nominal tregojnë rritje vjetore ekonomike të kësaj komune por kur dihet niveli i zhvillimit dhe i nevojave të popullësisë kjo rritje realisht është ende e ulët. Në periudhën e pasluftës shumë investime ishin të mbikqyrura dobët dhe të punuara shkel e shko dhe nuk treguan qëndrueshmëri dhe dobi afatgjate. Reformat pronore u vonuan dhe privatizimi u përcoll me dobësi të medha dhe nuk dha fryte të kërkuara prandaj të tëra këto vlera përcjellëse me këto rritje nuk ishin rezultat i shëndrrimit të kësaj rritje të zhvillimit ekonomik. Kjo në krahasim me nivelin e zhvillimit dhe nevojave del të jetë e pamjaftueshme për tejkalim të gjendjes dhe për ndonjë rritje të konsiderueshme. Ndikimet e rritjes globale e nivel vendit dhe rajonale dhe problemet e krizave të jashtme shfaqen me efekte të drejtpërdrejta e të theksuara në rritjen apo rënien ekonomike në këtë komunë. Mungesa e investimeve të jashtme dhe atyre të jashtme si dhe niveli i ulët i investimeve kapitale nga buxheti dhe niveli i intergrimeve në rajon tregojnë më së miri shkallën e zhvillimit ekonomik në këtë komunë. Numri i vendeve të reja të punës që krijohen brenda i viti në këto ndërmarrje prodhuese është i ulët. Ky faktor primar i zhvillimit ende është jasht procesit aktiv në krijimin e të ardhurave dhe kontributit të tij në mirëqënie sociale. Produktiviteti në këtë sektor ende është i ulët ndërsa popullësia e komunës është kryesisht shoqëri konsumuese pasojat në rritjen ekonomike, papunësinë dhe varfërin kanë shkaktuar mbështetjen në masë të madhe të ndërmarrjeve prodhuese të importit të lëndës së parë rasti konkret fabrika e birrës në Pejë importon tërë sasinë e maltit nga Rusia të cilat importe kanë shkaktuar norma të

Mobilizimi i kursimit të diasporës kosovare, Govori . Fadil . RINVEST, Prishtinë, 1997.



Burimi : Pengesat kryesore me të cilat ballafaqohen investitorët e huaj. RINVEST, 2012, Prishtinë.

larta të deficitit të llogarive rrjedhëse të këtyre ndërmarrjeve tregu i produkteve të ndërmarrjeve prodhuese në komunën e Pejës ende është i kufizuar. Kjo problematikë përkundër marrëveshjes së CEFTA-së e përcjellin probleme në tregtin e lirë me Serbinë dhe Bosnjën dhe Hercegovinën. Procesi i privatizimit nuk ishte i suksesshëm sa duhet dhe mjetet nga shitja e privatizimit nuk iu kthyen ekonomisë për një kohë të gjatë, njëherit infrastruktura ligjore është në proces të konsolidimit, gjyqësori ende jo efikas dhe ende jo i pavarur sa duhet dhe nën presion të grupeve të interesit, pra të gjithë këta tregues flasin për sfidat dhe nevojat e mëdha për rritje ekonomike dhe përgjithësin sociale. Nevojat për investimet në ndërmarrjet prodhuese janë shumë të mëdha sidomos në sektorin e bujqësisë. Vitet e fundit shihen shkëndijat e para se qeveria qendrore ka rritur grantet për bujqit dhe fermerët. Edhe pse tregu i brendshëm kosovar është realtivisht i vogël ai ende mbulohet nga importi për shumicën e produkteve. Ky treg është potencial për prodhuesit eventual gjegjësisht për prodhuesit e komunës së Pejës dhe përpjekjet janë të shumta që të konsumatori të krijohet bindja se produktet vendore janë po aq të mira në krahasim me ato të importit.

Promovimi i këtyre produkteve është me rëndësi të veçantë, tradita e ndërmarrjeve prodhuese në komunën e Pejës është shumë më e re se sa ndërmarrjet prodhuese në rajon kjo ka bërë që këto ndërmarrje të rajonit të ketë me prodhime të veta tregjet e përvetsuara shumë më herët.

Nga strategjia e zhvillimit ekonomik të komunës së Pejës shihet se për rritjen ekonomike duhet të planifikohen rrugët, hapësira të zhvillimit urban, tregjet, zonat agrare dhe ato energjetike. Prandaj qeverisja lokale njëra ndër preokupimet kryesore ka zbutjen e varfërisë e që sipas statistikave është e theksuar se bashku me papunësin.

Hipotezat dhe metodologjia e punimit

Hipoteza e punimit është:

Ndërmarrjet prodhuese nuk kanë një qëllim të vetëm që është fitimi mbi mesataren por edhe instrumentin e shërbimit social.

J.M. KEYNES 60 vjet pas vdekjes së tij mbeti në fuqi se ekonomia duhej të kishte qëllim primar vënien e saj në shërbim të njëzve por në kontestin tonë të mos e irritoj tregun dhe efektivitetin e shtetit. Nga analizat e ndërmarrjeve prodhuese të komunës së Pejës duke marrë për bazë statistikën dhe të dhënat kontabel të këtyre ndërmarrjeve shihet një rritje e ndjeshme nominale e forcës së krahut së punës. Rol të rëndësishëm që vlen të përmendet është kompania Devolli me grumbullimin e qumështit nëpër pikat e shumta të fermerët në rajonin e Pejës dhe më gjere si dhe industria e miellit Dardania poashtu me pikat e grumbullimit të grurit jo vetëm në rrafshin e Dukagjinit por në një pjesë të madhe të Kosovës si dhe kompania ELKOS group në grumbullimin e produkteve bujqësore të cilat ruhen në frigo me kapacitete të mëdha dhe mishit për të cilat ka stimuluar zhvillimin e blegtorisë në rajonin e Pejës dhe me gjere. Këto refleksione janë shenja positive në punësime sekondare të popullsisë së komunës së Pejës.

Metodologjia e punimit

Për realizimin e këtij punimi është përdorur një metodologji e të dhënave sasiore dhe cilësore. Të dhënat sasiore janë grumbulluar përmes planeve të ndërmarrjeve prodhuese në komunën e Pejës, janë bërë pyetësorë me menaxher të këtyre ndërmarrjeve të cilat janë të strukturuar në pyetje të mbyllura. Intervistat janë gjysmë të strukturuar, të dhënat cilësore janë të punuara me programin EXEL. Bazë ku mbështetet punimi është specifikimi dhe fokusimi në variabla që jep gjuhë specifike për të shtjelluar dhe spjeguar problemin. Punimi bazohet në shkollën historike gjermane ku mbështetet kërkimi teorik sepse fenomenet ekonomike të këtyre ndërmarrjeve gjykohen dhe vlerësohen si produkte të një kontesti historik kulturor dhe institucional.

Analizë interpretimi i të dhënave

Të mbjellurat vjeshtore sipas komunave me grur ku mbulohej nga IM “Dardania”

Të mbjellurat e planifikuara dhe realizimi	Sipërfaqja e realizuar	Numri i koperantëve
Komuna e Pejës	200 Ha	
Komuna e Deçanit	502 Ha	650
Komuna e Istogut	2838 Ha	400
Komuna e Klinës	3044 ha	1100
Totali	8584 ha	2760
Parcelat më < 2ha= 35% e totalit të mbjelljeve që = 3004 ha.		3004
Totali i mbjelljeve	11588 ha * 3.5t /ha = 40558t	5764
40558t * 56% = 22713t miell dhe 40558*29% = 11762t ushqim kafshe		5764
Kapaciteti prodhues vjetor	27458t-22713=4745	5764
Importet e lëndës së parë grurit sipas kapacitetit	4745t	5764
Përqindja e lëndës së parë grurit vendor	79 %	5764

Burimi : Elaborati I lëndës së parë IM “Dardania” . Viti 2014.

Nga të dhënat e planifikimit të lëndës së parë në IM “Dardania” shihet se 79 % e lëndës së parë sigurohet nga tregu i vendit ndërsa 21.1 % është lënda e parë nga importi. Krahasuar viti 2014 me vitin 2006 ka rritje të koperantëve nga 300 sa ishin në vitin 2006 në 3205 në vitin 2014 me tendencë rritjeje. Tendenca e rritjes sipas planit të industrisë së miellit Dardania është shtrirja e pikave të grumbullimit në rajonin e Drenicës dhe Anamoravës dhe planifikon që numri i koperantëve të rritet edhe për 300. IM prodhon edhe miell dietal nga misri të cilin deri në vitin 2014 90% e lëndës së parë importohet kryesisht nga Serbia. Ndërsa ushqimi për kafshë është rezultat i nus produktit të miellit në përqindje 79.1%.

Nga skema e furnizimit të lëndës së parë qumësht nga koperantët dhe fermerët e komunës së Pejës, Klinës dhe Istogut që do të thotë nga rajoni i Pejës shihet se lënda e parë e siguruar në komunën e Pejës avanson lehtë me atë të Klinës dhe Istogut.



BURIMI : Skema e furnizimit të qumështores VITA në Pejë.

Komuna	Baza mujore, Liter	Cmimi grumbullues	Vlera mujore	Muaji	Vjetore
Pejë	25470	0.35	8915	12	106974
Klinë	24850	0.35	8698	12	104370
Istogu	23840	0.35	8344	12	100128
Totali	52700	0.35	51153	12	613836

BURIMI : Furnizimi me lëndë të parë nga kompania Devolli për vitin 2014.

Nga tabela shihet se kjo kompani ka rritur mirëqënien sociale të qytetarëve të tri komunave për 613836 euro ndërsa nga kapacitetet e prodhuara të kësaj kompanie të produktit qumësht 52700 litra del se vetëm 29% të këtij produkti furnizohet nga tregu I brendshëm me lëndë të parë ndërsa 71% sigurohet nga importi si qumësht pluhur. Kjo për shkak të mungesës të subvencionimit nga ana e qeverisë dhe problemet e TVSH-së në blerje.

Konkluzione, Rekomandime

Në pamundësi të prodhimit të teknologjisë bashkëkohore në vendin tonë, dhe mungesa e investitorëve të jashtëm për këto prodhime kërkohet nga politika fiskale që ti liroj nga pagesa doganore dhe TVSH-së të gjithë importuesit e kësaj teknologjie për nevoja të prodhimit. Mungesa e kapitalit në këto ndërmarrje favorizon importin e makinerisë së gjysmë të përdorur. Liberalizimi I importit të makinerisë së tillë është I mirëseardhur ngase kushton më lirë dhe është I mjaftushëm për këtë fazë fillestare të konsolidimit të veprimtarive prodhuese në komunën tonë. Duhet shfrytëzuar moshën e re të popullsisë dhe nevojën për punë të gjeneratave të reja të shkolluara të cilat premtajn përdorim cilësor të kësaj cilësie.

Në këto ndërmarrje është I domosdoshëm investimi në shkollimin e gjeneratave të reja në formë të bursave dhe kredive studentore për degë dhe profile të cilat janë të domosdoshmë për këto ndërmarrje prodhuese. Ti ipet prioritet avansimi teknologjik në mënyrë që të zvogëlohet kostoja e prodhimit e cila mundëson produktivitet më të lartë dhe eksport më të madh në mënyrë që të përmisohet bilanci tregtar i Kosovës në përgjithësi. Në realitetin tonë duhet dhënë prioritet ekonomisë së vogël kryesisht Peja ka kushte ideale për agrobiznes e cila me prodhimet e veta do të plotësonte nevojat e tregut Kosovar.

Kjo do të kishte efekt në përvojën dhe konsolidimin e kulturës prodhuese të kësaj komune, zbutjen e papunësis dhe uljen e varfërisë. Të eliminohen barrierat formale të cilat janë të dëmshme për ambientin e këtyre ndërmarrjeve. Duhet infrastruktura ligjore ta kryej funksionin e vet, të paguhen taksat buxhetit të Kosovës dhe të jenë jashtë frymës të politikave ditore. Luftimi I dukurive negative në qeverisje lokale sic janë korrupsioni, dhuna, informaliteti dhe kontrabanda është obligim juridik I egzekutivit. Të gjitha këto dukuri ndikojnë negativisht në zhvillimin e këtyre ndërmarrjeve prodhuese, prandaj eliminimi I këtyre dukurive negative është oksigjen për frymëmarrje më të mirë të këtyre ndërmarrjeve prodhuese të cilat janë shpresë e qytetarëve të komunës së Pejës për rritje ekonomike dhe mirëqënie sociale të komunës sonë. Drejtorati për bujqësi, pylltari dhe hidroekonomi të jetë në bashkëveprim me ministrinë e bujqësisë dhe të bëjë kërkesë për grante dhe subvencione për bujqit dhe blegtorët e kësaj komune të cilet mund të rrisin prodhimet e tyre, kapacitetet prodhuese të ndërmarrjeve egzistuese. Mjedisi I këtyre ndërmarrjeve në komunën e Pejës si dhe pozita gjeografike e kësaj komune, toka e plleshme, uji I kualitetit të lartë dhe klima e përshtatshme e karakterizojnë këtë mjedis të kësaj komune me mundësi të zhvillimit të industrisë ushqimore në mënyrë që produktet ushqimore të importuara të zevendesohen me ato vendore.

Bibliografia

- Pasuria e kombeve Adam Smith, Tiranë : Dita 2000, 2005
 Manaxhimi i operacioneve : koncepte, metoda, strategji Suzana Panariti.
 Tiranë : Adelprint, 2008 Bot. i 3-të.
 3. Microeconomic Analysis (3-d Edition), Hal R. Varian. Norton & Company - New York - London; 2008.
 Bazat e Menaxhimit, Robbin&DeCenco , 2010, UET Press.
 Biznesi nderkombetar, I. Kristo, Shtepia botuese e librit universitar, Tirane.
 Dilemat e zhvillimit : modelet e zhvillimit ekonomik dhe social përballë globalizimit.
 Adrian Civici Tiranë : Geer, 2007.
 7.Economics Paul A. Samuelson; William D. Nordhaus, Boston : McGraw-Hill Book Co
 D. ZH. E. Strategjia per zhvillimin e komunës së Pejës, 2013/2017.
 Plani dhe analiza e lendes së parë në IM “ Dardania” viti 2014.
 Plani analiza e lendes së parë në Devolli company, viti 2014.

Burime nga interneti.

- www.devolli.com
 www.dardania.com
 www.bibita.com
 www.birrapeja.com
 www.elkoscenter.com

GJERIMI I PUNËVE TË TJETRIT NË KODIN CIVILSHQIPTAR.PRAKTIKAGJYQËSORE SHQIPTARE. VËSHTRIM KRAHASUES

PROF. ASOC. DR. ENDIRA BUSHATI

Pedagoge

Universiteti Evropian i Tiranës

Tirana, Albania

Mobile: +355 (0) 692061649

E-mail: ebushati@gmail.com

ABSTRAKT

Gjerimi i punëve të tjetrit parashikohet në nenet 648-652 të Kodit Civil Shqiptar. Ky institut e ka origjinën që nga e drejta romake dhe ka vazhduar të ekzistojë deri në ditët e sotme, duke pasur një ekzistencë të vetën, të ndarë nga begatimi pa shkak. Kujdesi që rrethon padinë e gjerimit, ka qëllim final mbrojtjen e lirisë individuale, pra të shmangë që dikush mund të jetë i detyruar të paguajë për një send apo shërbim që ai nuk e dëshiron. Në Civil Law, kërkesat për mbrojtjen kundër vendosjes së një përgjegjësie nga begatimi, ndjehen më shumë në fushën e gjerimit të punëve, sesa të begatimit pa shkak. Ndryshimet e dukshme që, të paktën në pamje të parë, duket se ekzistojnë në këtë fushë mes sistemeve të Common Law dhe Civil Law, kanë tendencë në praktikë të zbehen. Nga njëra anë, në kontinent, instituti i gjerimit të punëve të tjetrit, edhe pse parimisht i pranuar, është i rrethuar nga kujdese të shumta të diktuar nga kërkesat për mbrojtje të lirisë individuale, që e kufizojnë shumë fushën e veprimit; nga ana tjetër vetë këto kërkesa kundër vendosjes së një përgjegjësie nga begatimi, veçanërisht të dukshme në vendet e Common Law, i çojnë juristët e common law të mohojnë parimisht mundësinë për të pretenduar ndonjë formë dëmshpërblimi për shërbime eventuale të bëra në një situatë emergjence.

Shkrimi synon analizën juridike të institutit në Kodin Civil Shqiptar, duke pasqyruar edhe ato pak raste nga praktika gjyqësore shqiptare. Vështrimi krahasues pasqyron dallimet mes gjerimit të punëve të tjetrit dhe begatimit pa shkak, duke zgjidhur konfuzionin mes dy padive të ndryshme, që nuk është i rrallë në praktikë.

Fjalë kyç: detyrim, gjerim i punëve të tjetrit, begatim pa shkak, padi, pagim.

1. Vështrim historik në legjislacionin shqiptar

a) Kodi Civil i Zogut

Kodi Civil i 1929 u hartua nën ndikimin e drejtëpërdrejtë të modeleve romaniste të së drejtës private, me ndikim ta qartë italo-francez.¹ Vetë Kodi, ka në fund të tij një *Tabelë Konkordimi midis Kodit Civil Shqiptar dhe kodeve të huaja*, ku duket qartë referimi tek Kodi Civil italian, francez, zviceran, gjerman, egjiptian, dispozitat paraprake të Kodit Civil Italian dhe Projekti i përbashkët italo-francez mbi obligimet.

Në Seksionin III, nenet 1136-1140, trajtohet *gjerimi i punëve*, pa harruar dhe përkthimin në frëngjisht të termit (*gestion d'affaires*), duke dëshmuar qartë ku ishte bazuar legjislatori.

Në nenin 1136 jepet kuptimi i gjerimit: *“Ai që, pa qenë i obliguem, duke ditun merr përsipër gjerimin e një pune të tjetrit, detyrohet me vazhdue dhe me përfundue gjerimin e filluem deri sa i interesuemi të jetë në gjendje me u kujdesue vetë. Gjeruesi i shtrohet gjithë obligimeve, që do të rezultonin për të, sikur të kish një porosi të shprehun prej të interesuarit. Ai që asht i pazoti me pranue një porosi, asht i pazoti me u obligue edhe si gjerues punësh: megjithëkëtë, asht përgjegjës për damet e shkaktueme prej tij dhe detyrohet brenda kufijve të begatimit pa shkak.”* Neni 1137 parashikon: *“Gjeruesi, edhe sikur i interesuemi të vdesë para se puna të mbarohet, detyrohet me vazhdue gjerimin, deri sa trashëgimtari të mundet me marrë drejtimin e asaj pune.”*

Neni 1138 përcakton detyrimet e gjeruesit: *“Në gjerimin e punës, gjeruesi detyrohet me vënë gjithë kujdesin e një ati familjeje të mirë. ...gjyqtari, duke marrë parasysh cirkonstancat që kanë shtyrë gjeruesin me marrë përsipër atë punë, mundet me ulë shpërblimet e dameve që kanë rezultue nga faji i tij.”*

Ndërkohë, *“Në qoftë se puna asht administrue mirë, i interesuemi duhet të përmbushë obligimet që ka lidhë gjeruesi në emër të tij, të zhdamtojë këtë për të gjithë obligimet që ka marrë personalisht dhe t'i paguajë gjithë shpenzimet e nevojshme ose të dobishme, bashkë me kamatat që prej ditës që janë ba. Kjo dispozitë nuk aplikohet për gjerimin e marrë përsipër ose për veprimet gjerimi të ekzekutueme kundra ndalimit që ka ba i interesuemi, përveç kur ky ndalim asht në kundërshtim me ligjin, me rendin publik ose me zakonet e mira”.*

Ratifikimi nga ana e të interesuarit sjell efektet e porosisë për gjerimin, *“edhe sikur ky të jetë ekzekutue prej një personi që kujtonte se gjeron një punë të vet.”*³

Kodi i 1929 trajtonte gjerësisht figurat e pagimit të padetyruar dhe gjerimit të punëve të tjetrit, edhe pse përta i përket begatimit pa shkak është kufizuar vetëm ta shpallë si parim të përgjithshëm.

b) Ligji nr.2359, datë 15.11.1956 “Mbi veprimet juridike dhe detyrimet”

Ligji “Mbi veprimet juridike dhe detyrimet” i vitit 1956, në përputhje të plotë me frymën e regjimit të vendosur, në nenin 33 përcaktonte: *“Detyrimet lindin nga aktet e planifikimit të ekonomisë popullore, nga veprimet juridike të parashikuara në ligje dhe veçanërisht nga kontratat, si dhe nga shkaktimi i dëmit dhe nga begatimi pa shkak.”*, duke e renditur kështu begatimin pa shkak si burim të lindjes së detyrimeve.

Detyrimet që lindin nga begatimi pa shkak trajtohen në kapitullin XXIX, në nenet 501-504.

Ndwsa, në Kapitullin XXI parashikohet *“Veprimtaria në dobi të një personi tjetër pa porosinë e tij”*, në nenet 385-389. Legjislatori nuk e ka quajtur “të arsyeshme” ta cilësojë gjerim të punëve të tjetrit.

Neni 385 përcakton: *“Personi që vepron për të ndaluar një dëm që u kanoset interesave pasurore të një personi tjetër, pa porosinë e këtij, ka të drejtë të kërkojë që t'i paguhen shpenzimet e nevojshme që ka bërë për këtë qëllim. Personi që ka vepruar në dobi të një personi tjetër pa porosinë e tij është i detyruar t'i dorëzojë këtij personi gjithçka ka marrë për shkak të kësaj veprimtarie.”* Ndërkohë, personi që vepron në dobi të një personi tjetër pa porosinë e tij është i detyruar ta shpërblejë këtë për dëmin që i është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e tij e rëndë (neni 386). Neni 387 përcakton detyrimet e gjeruesit. Personi gjerues është i detyruar të lajmërojë sa më parë personin e interesuar për këtë veprimtari dhe kur nuk ka mundësi, është i detyruar të vazhdojë gjer në fund veprimtarinë e filluar. Kur personi gjerues, megjithëse ka patur mundësi, nuk ka lajmëruar personin e interesuar, ose, megjithëse ka patur udhëzime të kundërta nga personi i interesuar, ka vazhduar veprimtarinë e tij, është i detyruar t'i shpërblejë personit tjetër dëmin që i është shkaktuar edhe pa fajin e tij.

c) Kodi Civil 1981

Kodi Civil i 1981 në Kreun V, nenin 140, përcakton burimet e lindjes së detyrimeve. *“Shteti organizon, drejton e zhvillon tërë jetën ekonomike e shoqërore me plan unik dhe të përgjithshëm. Burim kryesor i lindjes së detyrimeve në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë janë aktet e planifikimit të ekonomisë socialiste të tjera nga organe kompetente.*

Detyrimet lindin edhe nga veprimet juridike të parashikuara nga ligji dhe veçanërisht nga kontrata, nga shkaktimi i dëmit dhe nga përfitimi pasuror pa të drejtë.

Në Kreun IX, neni 350 përcakton Detyrimet që lindin nga përfitimi pasuror pa të drejtë: *“Personi që ka përfituar ose ka kursyer një pasuri në dëm të një personi tjetër pa ndonjë shkak të ligjshëm ose për shkak që nuk është vërtetuar ose është zhdukur me pas*

¹Veprimet juridike, Ardian Nuni, Tiranë, 2001, Julvin, f.9-18

shih Kodi Civil i 1929, botimet Toena 1998, f.549

Neni 1140 Kodi Civil 1929

detyrohet të kthejë atë që ka përfutuar ose kursyer në dëm të tjetrit.” Personi që ka fituar një send të tjetrit pa një shkak të ligjshëm, detyrohet ta kthejë atë bashkë me të ardhurat që ka nxjerrë ose që duhet të nxirte, por ka të drejtë të kërkojë pagimin e shpenzimeve që ka bërë për sendin, sipas dispozitave të padisë për kërkimin e sendit nga nëdorësi i paligjshëm (nenet 135-138 të këtij Kodi).

Në nenin 64 përcaktohet: *“Nuk mund të kërkohet kthimi i sendeve ose i të hollave që një person ka dhënë vullnetarisht për përmbushjen e një detyrimi, i cili, megjithëse i pakërkueshëm, nuk është i pavlefshëm, ose që ka dhënë për përmbushjen e një detyrimi të veçantë për të në pajtim me rregullat e moralit socialist”.*

Ndërkohë, ky kod “nuk e ka parë të arsyeshme” të rregullojë institutet e pagimit të padetyruar dhe të gjerimit të punëve.

2. Gjerimi i punëve të tjetrit në Kodin Civil shqiptar

Gjerimi i punëve të tjetrit në Kodin Civil shqiptar është parashikuar në Titullin V, në nenet 648-652. Neni 648 jep përkufizimin: *“Ai që, pa qënë i detyruar, merr përsipër me ndërgjegje dhe për një qëllim të arsyeshëm gjerimin e punëve ose interesave të tjetrit, është i detyruar ta vazhdojë atë derisa personi i interesuar të jetë në gjendje të kujdeset vetë.”* Sipas nenit 649, personi i interesuar duhet të:

të përmbushë detyrimet që gjeruesi ka marrë në emër të tij; b) të përjashtojë gjeruesin nga detyrimet që ka marrë në emër të vet; c) t’i paguajë atij shpenzimet e nevojshme e të dobishme që nga dita që janë bërë; dhe d) kur është rasti, t’i shpërblejë edhe dëmin që mund të ketë rrjedhur nga gjerimi, me kushtin që veprimet e kryera nga gjeruesi të mos kenë qënë ndaluar nga personi i interesuar.

Paragrafi i dytë i këtij neni përcakton: *“Kur gjeruesit, përveç gjerimit të punëve, i është dashur për këtë qëllim të ushtrojë një profesion, ka të drejtë të shpërblehet në përputhje me çmimet ose tarifat e caktuara për aktivitetet të tilla.”*

Ndërkohë, gjeruesi ka të drejtë të kryejë veprime juridike në emër të personit të interesuar, në masën që interesi i këtij të fundit plotësohet në mënyrë të përshtatshme. Neni 651 përcakton detyrimet e gjeruesit, të cilat janë të njëjta me detyrimet që rrjedhin nga një kontratë porosie. Gjykata mund të pakësojë dëmshpërblimin për dëmin që është shkaktuar për faj të gjeruesit, duke marrë parasysh rrethanat të cilat kanë ndikuar tek ai për të marrë përsipër gjerimin. Megjithatë, personi i interesuar, me anë miratimi të veprimtarisë së gjeruesit, mund të tërheqë të drejtën e tij për të kërkuar dëmshpërblim nga gjeruesi, dhe për këtë qëllim personit të interesuar duhet t’i jepet një afat i arsyeshëm.

Rastet e padisë së gjerimit në praktikën gjyqësore shqiptare janë shumë të pakta. Ia vlen të përmendet një arsyetim i Gjykatës së Lartë në vendimin më poshtë.

Në çështjen Shoqëria “Përparimi”sh.a. v. KESH⁴, paditësi ka kërkuar rimbursimin e shpenzimeve të kryera për shkak të gjerimit të punës së të tjerëve në shumën 6.720000 lekë, duke bërë referim tek neni 648 KC. Gjykata e shkallës së parë dhe e Apelit e kanë pranuar padinë. I padituri ka ushtuar rekurs. Nga gjykimi rezultoi se, drejtori i shoqërisë, i kërkonte KESH-it furnizim të pandërprerë me energji elektrike, gjë për të cilën shoqëria ofroi si mundësi pagimin e të gjitha shpenzimeve për furnizimin e objektit të shoqërisë me energji elektrike me fuqi 1450 kw. KESH-i e informon shoqërinë se, e vetmja mënyrë për ta zgjidhur këtë ishte kryerja e investimeve nga ana e vetë shoqërisë për pjesën e parë të projektit për zonën, që konsistonte në ndërtimin e një linje të re nga nënstacioni Shkozet deri tek objekti i shoqërisë. Faza e dytë konsistonte në investimin për një dalje kabllorë në drejtim të plazhit Durrës dhe shpenzimet për këtë fazë do të kryeshin nga KESH-i. Shoqëria, pas miratimit të KESH-it, vendos t’i kryejë punimet me fondet e veta dhe lidh një kontratë zbatuese me shoqërinë zbatuese “Ndërtim Elektro”sh.p.k. Pas kryerjes së punimeve, drejtori i shoqërisë i drejtohet KESH-it për të marrë në shqyrtim mënyrën e likuidimit të shoqërisë, në lidhje me investimet e kryera në favor të KESH-it për realizimin e objektit. KESH-i nuk e ka përmbysur kërkesën dhe shoqëria i është drejtuar gjykatës. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmon: *“Të dy gjykatat kanë gabuar kur nuk dallojnë kontratën e sipërmarrjes, apo të porosisë nga njëra anë, dhe gjerimin e punëve të tjetrit, nga ana tjetër. Kjo e fundit konsiderohet si një marrëdhënie quasi kontraktore, d.m.th. ka elementë që e bëjnë të ngjashme me një kontratë, por nuk është e tillë. Gjerimi i punëve të të tjerëve, apo veprimtaria në dobi të një personi tjetër pa porosinë e tij, është veprimtaria e një personi që nuk është i detyruar nga ligji apo nga ndonjë veprim juridik (kontratë) për të kryer ndonjë punë, veprimtari administrimi, apo veprime të nevojshme për të shmangur ndonjë rrezik apo dëm që mund t’i shkaktohet ndonjë personi tjetër në pasurinë e tij. Këtë veprimtari personi i padetyruar e kryen me ndërgjegje dhe vullnet të mirë, duke qënë i bindur se ajo është veprimtari e dobishme dhe e nevojshme për të mbrojtur interesat pasurore të një personi tjetër dhe që, si e tillë, ajo normalisht do të mirëpritet, do të vlerësohet dhe do të pranohet nga ky i fundit. Gjithsesi, duke qënë se gjerimi i punëve të tjetrit bëhet në kushte emergjence, pa pasur mundësi që ai të lajmërohet, t’i merret paraprakisht pëlqimi dhe të arrihet marrëveshja për marrjen përsipër të detyrimeve të ndërsjellta, gjeruesi është i detyruar që në rastin më të parë të mundshëm të lajmërojë personin në interes të të cilit ka vepruar. Marrëdhënia juridike e gjerimit të punëve të tjetrit, që bazohet në një veprimtari të njëanshme me vullnet të mirë e në interes të tij, si rregull shndërrohet në një kontratë porosie kur personi, në interes të të cilit ka vepruar gjeruesi i punëve të tij, me të marrë vesh veprimet e gjeruesit, i jep atij të drejtën (mandatin) për të vazhduar të veprojë më tej në mbrojtje të interesave të tij. Në të kundërt, në rast të mosdhënies së pëlqimit, gjerimi i punëve të tjetrit merr fund si marrëdhënie juridike dhe palët zgjidhin midis tyre pasojat e gjerimit të punëve, duke marrë përsipër detyrimet përkatëse.”* Gjykata e Lartë vendosi me këtë arsyetim rrëzimin e kërkesës.

Vendimi nr. 00-2007-325 (167), datë 22.02.2007 i Gjykatës së Lartë

3. Gjerimi i punëve të tjetrit dhe liria individuale

Me gjerim të punëve të tjetrit kuptohet çdo veprim i kryer në interes të një personi tjetër pa qenë i detyruar paraprakisht. Për këtë, nuk mjafton një sjellje e thjeshtë materiale ose juridike që rezulton avantazhuese ndaj të tjerëve, por kërkohet që gjeruesi të ketë vepruar me ndërgjegje për t'i sjellë një dobi tjetrit (*animus aliena negotia gerendi*). Në të vërtetë, nuk ka qenë gjithmonë kështu. Që nga e drejta romake kundërviheshin në fakt dy konceptime të gjerimit të punëve: një subjektive, më rigoroze, tipike e të drejtës klasike, në bazë të së cilës ka gjerim të punëve të tjetrit vetëm në prani pikërisht të *animus aliena negotia gerendi*; një objektive, më pak rigoroze, që prezumohet e përpunuar në epokën postklasike, në bazë të së cilës edhe veprimet e kryera në interes të gjeruesit mund të lindnin gjerimin e punëve. Motivet e një shtrirje të tillë të fushës së veprimit të gjerimit të punëve janë të njohura. Padia e gjerimit të punëve të tjetrit, e privuar nga kriteri i qëllimit për të gjeruar një punë të tjetrit, shërbente për të ndrequr, të paktën pjesërisht, mungesën e njohjes të një padie të përgjithshme begatimi. Kjo situatë konfuzioni dhe pasigurie ka arritur të mbijetojë deri në fundin e shek 19, kur më në fund si jurisprudenca franceze me mësimet e Aubry dhe Rau, ashtu dhe legjislatori gjerman, arritën më në fund të ndajnë pastër të dy paditë: nga njëra anë padia e gjerimit të punëve të tjetrit, më në fund e çuar në shtratin e vet natyral, dhe nga ana tjetër padia e begatimit. Konfuzioni që akoma në shek 19 mbretëronte mes padisë së begatimit dhe asaj të gjerimit të punëve të tjetrit, nuk duket pa kuptim. Ajo evidenton faktin që bëhet fjalë për raste pa dyshim të afërta që, vetëm tani janë ndarë pastër. Në fakt, e njëjta sjellje materiale mundet të plotësojë kushtet si të një begatimi pa shkak, ashtu dhe të një gjerimi të punëve të tjetrit, p.sh. kur një person kryen punime mbi sendin e një tjetri. Nëse përmirësimet, riparimet, etj. janë kryer me qëllimin për t'i bërë një shërbim pronarit të sendit, bëhet fjalë për një rast gjerimi të punëve. Nëse, anasjelltas, kush ka kryer punimet, ka vepruar në interesin e vet ekskluziv, shtrihet çështja e begatimit pa shkak. Linja e ndarjes mes rasteve të begatimit pa shkak dhe asaj të gjerimit të punëve është padyshim e hollë, meqë bazohet mbi një kriter të karakterit ngushtësisht subjektiv, d.m.th. prania ose jo e qëllimit të gjerimit të punëve të tjetrit. Pavarësisht dukjes, bëhet fjalë për raste shumë më të afërta se mund të duken në pamje të parë, ose më saktë shumë më të afërta sesa zakonisht konsiderohen, sidomos në kontinent. Më e ndryshme shfaqet situata në vendet e *Common Law*, ku një proces i tillë ndarjeje dhe diferencimi të rasteve të ndryshme nuk është verifikuar akoma, ose ka gjithsesi vend në masë më të vogël sesa në kontinent. Juristët angloamerikanë nuk e perceptojnë dallimin mes pagimit të padetyruar dhe begatimit pa shkak në të njëjtat terma si e perceptojnë kontinentalët. Në vendet e *Common Law*, vërejnë një dallim të madh, sipas rastit nëse kalimi pasuror i detyrohet sjelljes të të varfëruarit apo të të begatuarit. Duke e vënë mënjënjë këtë hipotezë të dytë, që ka evoluar nga përgjegjësia civile falë doktrinës së *waiver*, e cila është ajo që i afrohet më shumë konceptit kontinental të begatimit, në të gjitha rastet e tjera zbatohen parime të ngjashme. Të njëjtat mjete quasi kontraktore që veprojnë në rastet e ndryshme të pagimit të padetyruar (veçanërisht *quantum meruit* dhe *quantum valebat*), veprojnë po kështu në rastet e ndryshme të begatimit që varen nga sjellja e të varfëruarit. Bëhet fjalë për mjete që kanë evoluar në fushën kontraktore si pasojë e solemnitetit të veçantë të sistemit origjinar të kontratave, gjë që ka kushtëzuar shumë karakteristikat, si dhe evolucionin e mëpasëm. Në veçanti, akoma sot, në të gjitha rastet në të cilat begatimi është prodhuar nga sjellja e të varfëruarit, është thelbësore për konfigurimin e detyrimit për kthim, që veprimi në njëfarë mënyre është kërkuar ose pranuar më pas. Kjo është e vërtetë jo vetëm në rastet që cilësohen pagim i padetyruar, por edhe në fushën e begatimit pa shkak, çdo herë kur begatimi është pasojë e sjelljes së të varfëruarit, gjë që përkthehet natyrisht në një mbrojtje shumë të fortë të individit kundër vendosjes së një përgjegjësie nga begatimi. Por ky është dhe motivi, për të cilin në vendet e *Common Law*, ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë e vështirë të konfigurimet diçka e ngjashme me institutin kontinental të gjerimit të punëve. Edhe gjerimi i punëve, i reduktuar në termat e vet thelbësorë, konsiston në fakt në një sjellje të të varfëruarit në avantazh të të begatuarit, d.m.th. hyn në kategorinë e begatimit që varet nga një sjellje e të varfëruarit, dhe ndërkohë shtrihet pranë si pagim i padetyruar, si rastet e tjera të begatimit që varen nga sjellja e të varfëruarit. Ai shtron (sidomos në sytë e juristëve të *common law*) të njëjtat probleme me ato mbi begatimet e detyruara. Në veçanti, vështirësia më e madhe konsiston në faktin që, gjerimi i punëve të tjetrit konsiston tipikisht në një sjellje të vënë në jetë në një situatë urgjence, pa një kërkesë paraprakisht apo shfaqje të vullnetit konform nga ana e të interesuarit. Dhe është pikërisht në këtë mungesë vullneti nga ana e të begatuarit për t'u detyruar, pra për të paguar një shumë parash për shërbimet e marra, që në sytë e juristëve të *common law* qëndron vështirësia më e madhe për të arritur në konfigurimin e përgjegjësisë për kthim. Megjithatë, kjo nuk përbën faktor çudie as për kontinentalët. Gjerimi i punëve të tjetrit, pikërisht për këto dy karakteristika, rrethohet nga shumë kujdes edhe në kontinent. Në radhë të parë është e qartë që askush nuk mund të gjerojë punën e tjetrit kundër vullnetit të vetë personit të interesuar.⁵ Funkcioni i këtij kufizimi është lehtësisht i kuptueshëm; t'i njohësh një të drejtë rimbursimi atij që ka vepruar kundër ndalimit të shprehur të të interesuarit, përbën një formë të rëndë cënimi të lirisë individuale, pra të lirisë që ka secili të disponojë siç e mendon më mirë për punët e veta. Një parim i tillë lirie mund të rezultojë i kufizuar vetëm në konfliktin me vlera superiore. Në të gjitha sistemet, është parashikuar një përjashtim nëse ndalimi i të interesuarit është në njëfarë mënyre kundër ligjit, rendit publik apo zakonisht të mirë (neni 679 BGB, neni 2031 KCI), p.sh. kush lë pa ushqyer një fëmijë, mund të jetë i detyruar të rimburojë atë që e bën në vend të tij, edhe kundër vullnetit të vet. Në të gjitha rastet e tjera, veprimi i gjerimit i vënë në jetë kundër vullnetit të të interesuarit, jo vetëm që nuk do t'i jepte asnjë të drejtë për t'u rimbursuar, por do ta vendoste gjeruesin përballë rrezikut të dënimit që të dëmshpërblejë dëmet eventuale, dhe kjo dhe në rastin kur nuk mund t'i ngarkohet faj tjetër (neni 678 BGB). Natyrisht në këto raste, ia vlen t'i drejtohesh padisë së begatimit përsa kohë, askush nuk mund të detyrohet të paguajë për një send apo shërbim të kryer kundër vullnetit të vet të shprehur.⁶

Pietro Serena, La gestione di affari altrui, G. Giappichelli Editore-Torino 2000, f. 17
Nenet 648-649 KCSH

Kujdesi me të cilin është rrethuar padia e gjerimit të punëve në kontinent, nuk është i kufizuar në përjashtimin e mundësisë së veprimit gjyqësor në rastet e gjerimit të kryer *prohibente domino*, por gjejnë shprehje në kushte të tjera të ndryshme të padisë së gjerimit. Pranohet përgjithësisht që, është e mundur të kërkohej rimbursimi i shpenzimeve të kryera, vetëm nëse është vepruar në një situatë, në të cilën i interesuari nuk ishte në gjendje ta përballonte vetëm, më tepër në situata emergjence. Shembulli më tipik është ai i një fqinji, i cili shuan një zjarr ose kryen shërbime të tjera urgjente në mungesë të pronarit, ose gjithësi në pamundësinë nga ana e tij për t'u përgjigjur personalisht. Falë gjithë këtyre kufizimeve, fusha e veprimit e gjerimit të punëve të tjetrit, rezulton gjerësisht e ridimensionuar. Bëhet fjalë për një institut, të pranuar në parim, por që në praktikë ka një fushë veprimi shumë të ngushtë. E dëshmon numri i rasteve shumë të pakta të gjerimit që gjenden, sidomos që kur padia e begatimit është ndarë përfundimisht nga ajo e gjerimit.⁷

Kujdesi që rrethon padinë e gjerimit, ka qëllim final mbrojtjen e lirisë individuale, pra të shmangë që dikush mund të jetë i detyruar të paguajë për një send apo shërbim që ai nuk e dëshiron. Në kontinent, kërkesat për mbrojtjen kundër vendosjes së një përgjegjësie nga begatimi, ndjehen më shumë në fushën e gjerimit të punëve, sesa të begatimit pa shkak. Duket po aq qartë se si diferencat e dukshme që (të paktën në pamje të parë) duket se shtriheshin në këtë fushë mes sistemeve të *Common Law* dhe *Civil Law*, kanë tendencë në praktikë të zbehen. Nga njëra anë, në kontinent, instituti i gjerimit të punëve të tjetrit, edhe pse parimisht i pranuar, është i rrethuar nga kujdese të shumta të diktuar nga kërkesat për mbrojtje të lirisë individuale, që e kufizojnë shumë fushën e veprimit; nga ana tjetër vetë këto kërkesa kundër vendosjes së një përgjegjësie nga begatimi, veçanërisht të ndjera në vendet e *Common Law*, i çojnë juristët e *common law* të mohojnë parimisht mundësinë për të pretenduar ndonjë formë dëmshpërblimi për shërbime eventuale të bëra në një situatë emergjence. Ky rregull pëson përjashtime të shumta, me pasojën që në planin operativ diferenca reale, që gjithësi qëndron, rezulton gjerësisht e zbehtë.

4. Pagimi i borxhit të tjetrit

Prova e parë për të matur diferencat mes sistemeve të *Common Law* dhe *Civil Law*, qëndron tek pagimi i borxhit të tjetrit. Në këtë fushë, duhet dalluar sipas rastit kush ka paguar borxhin e tjetrit, ka vepruar apo jo në bazë të një gabimi. Nëse kush ka paguar, kujtonte se ishte personalisht i detyruar ose i detyruar për të shuar një borxh të vetin, do të shtrihet problemi i pagimit të padetyruar. Këtu ka interes vetëm hipoteza që ngelet, pra rastet kur dikush ka shuar një borxh të tjetrit me bindjen se paguan borxhin e tjetrit dhe me qëllimin për t'u rimbursuar.

Ndërkohë që në vendet e *Civil Law*, pagimi i një borxhi të tjetrit përbën një shembull tipik të gjerimit të punëve, me pasojën që gjeruesi, përsa ekzistojnë të gjitha kushtet e gjerimit (urgjenca, *absentia domini* etj), mund të pretendojë rimbursimin nga debitori, e ndryshme shfaqet situata në vendet e *Common Law*. Parim bazë i të drejtës angloamerikane është në fakt që askush nuk mund të imponojë të tjerët me detyrime kundër vullnetit të vet.⁸ Në vendet e *Common Law*, ndjehet shumë kërkesa për të shmangur vendosjen e një përgjegjësie nga begatimi. Në të gjitha rastet, në të cilat begatimi është prodhuar nga një sjellje e të varfëruarit, përjashtohet parimisht konfigurimi i detyrimit për kthim, përveç, natyrisht, kur sendi ose shërbimi është kërkuar paraprakisht ose pranuar më pas. Dhe meqë gjerimi i punëve të tjetrit lind, me përkufizim, në situata të urgjencës, në të cilat nuk është e mundur të kërkohej autorizimi i të interesuarit, kjo përkthehet në një mohim total të mbrojtjes së gjeruesit. Ky rregull mund të duket shumë i ashpër, sidomos për kontinentalët që qëkur janë mësuar të pranojnë të drejtën e gjeruesit për t'u rimbursuar, por ajo është krejtësisht konform shpirtit anglosakson dhe është pasojë direkte e parimeve të *law of restitution*.

Mëgjithatë, një rregull i tillë pëson përjashtime të ndryshme, që mbushin të paktën pjesërisht boshllëkun ekzistues në këtë fushë mes të drejtës kontinentale dhe angloamerikane. Një përjashtim i madh është zhvilluar në fushën e *law of agency*. Pranohet që, nëse një *agent*, një person i caktuar për të kujdesur interesa të caktuara, një përfaqësues etj, gjendet në një situatë emergjence, ai mund të operojë në interes të *principal-it*, edhe pa marrë paraprakisht autorizimin (*agency of necessity*).⁹ *Agency of necessity* përbën një institut, për shumë aspekte, paralel me institutin kontinental të gjerimit të punëve. Kërkohej në fakt që *agent* të ketë vepruar në një situatë emergjence, në interes të *principal* dhe në pamundësinë për t'u vënë direkt në kontakt për të marrë udhëzime. Nëse rezultojnë të integruara të gjitha këto kushte, *agent* mund të pretendojë, edhe gjyqësisht, për t'u rimbursuar nga *principal-i*. Ky institut, dikur i kuptuar në mënyrë rigorozë dhe i zbatuar vetëm në rastet e *agency* të vërtetë, priret të zbatohet me njëfarë elasticiteti edhe në prani të raporteve *fiduciary* të një natyre tjetër. Pavarësisht këtyre shtrirjeve, *agency of necessity* vazhdon të përbëjë një institut me fushë zbatimi shumë të ngushtë. Për t'iu drejtuar, është thelbësore të vërtetohet ekzistenca e një raporti *agency* ose e një raporti tjetër besimi të barazvlershëm. Jashtë rasteve të këtij lloji, mundësitë e rimbursimit të atij që ka shuar një borxh të tjetrit janë shumë të kufizuara. Megjithatë, ka disa raste, në të cilat gjyqtarët angloamerikanë pranojnë të drejtën për t'u rimbursuar (*reimbursement*) edhe në mungesë të një raporti *agency*. Për këtë, kërkohej që kush ka kryer pagesën, të ketë vepruar në radhë të parë në interesin e vet. Për të sqaruar konceptin merret një shembull: në çështjen *Exall v. Partridge* (1799), pronari i disa karrocave i kishte depozituar ato në tokën e marrë me qira nga një person tjetër. Në një moment, kush kishte marrë me qira tokën, kishte pushuar së paguari qiranë, me pasojën që titullari i tokës la në peng karrocet në garanci të kredisë së vet. Në këtë pike, ndërhyri pronari i karrocave, i cili procedoi personalisht për të shuar borxhin me qëllim që të merrte posedimin e karrocave të veta. Ky po kështu veproi në gjyq kundër qiramarrësit të

Në Shqipëri këto raste janë pothuajse inekzistente. Sipas buletineve të Ministrisë së Drejtësisë, paraqiten 5-6 padi gjerimi në vit, ku shumica prej tyre përfundon me tërheqjen e paditësit nga gjykimi.

⁸ G. Virgo, *The principles of the law of restitution*, Oxford University Press 1999, f. 398
⁹ Goff dhe Jones, *The law of restitution*, Sweet&Maxwell, bot. 6, 2002, f.332

tokës për t'u rimbursuar, duke e fituar çështjen. Gjyqtarët konsideruan që, meqë kishte qenë i detyruar të shuante borxhin në radhë të parë për të mbrojtur një interes të vetin të natyrës pasurore, mund të konfigurohej detyrimi për kthim.

Në konkluzione të ngjashme u arrit në çështjen *Johnson v. Royal Mail Steam Packet Co.* (1867), ku një shoqëri kishte lënë me qira një anije. Qiramarrësi nuk i pagoi marinarët, të cilët arritën të vendosnin peng anijen në garanci të kreditit të tyre. Shoqëria titullare i pagoi personalisht pagat e marinarëve, me qëllim që të rimerrte anijen. Më pas veproi gjyqësisht kundër atij që kishte marrë me qira anijen për t'u rimbursuar, duke e fituar çështjen. Akoma dhe një herë kush kishte shuar një borxh të tjetrit, kishte vepruar në fakt në radhë të parë për të mbrojtur një interes të vetin të natyrës personale.

Shumë kuptimplotë është dhe një vendim i filimshek *20: Brook's Wharf & Bull Wharf Ltd. V. Goodman Bros* (1937), ku, një importues kishte importuar nga Rusia një seri peliçesh dhe i kishte depozituar pranë një magazinieri. Magazinieri konform parimeve juridike të epokës, konsiderohej i detyruar në mënyrë solidare me importuesin për pagimin e taksave të importimit. Ai u detyrua të paguante në vend të pronarit. Ndërkohë peliçet u vodhën kur gjendeshin të depozituara në magazinë. Si pasojë importuesi nuk kishte më asnjë qëllim të rimbursonte magazinierin për taksat doganore. Ky iu drejtua gjykatës, duke fituar. Ai kishte shuar borxhin e tjetrit jo spontanisht, por si solidar përgjegjës për pagimin e taksave.

5. Necessaries

Një tjetër grup rastesh konsiston në furnizimin e sendeve ose të shërbimeve të nevojës së parë personave që kanë të drejtë për ushqime. Shembulli më tipik është ai i një të treti të huaj, i cili kujdeset për fëmijët apo gruan e tjetrit. Në këto raste, në të gjitha sistemet e konsideruara konfigurohet detyrimi për kthim për të detyruarin për ushqime. Situata në radhë të parë është e evidente në vendet e *Civil Law*, ku asnjë ndalim eventual i të detyruarit për ushqime, do të vlente të pengonte lindjen e një përgjegjësie për kthim.¹⁰ Një ndalim e tillë do të ishte qartësisht kundër zakonisht të mirë dhe si i tillë joefikas.

Situata paraqitet krejtësisht e ngjashme në vendet e *Common Law*, ku përmbushja e një detyrimi të natyrës ushqimore nga një i tretë, jep gjithmonë të drejtë për rimbursim. P.sh. në *Jenkins v. Tucker* (1788) është vendosur rasti i mëposhtëm: një burrë kishte lënë gruan dhe fëmijën në Angli dhe kishte shkuar të kërkonte fatin në Xhamajkë. Gjatë mungesës së tij, ai u zëvendësua në detyrimet e veta ushqimore karshi gruas dhe fëmijës nga babai i gruas, i cili me vdekjen e gruas u kujdes dhe për varrimin dhe për shpenzimet e tjera. Pas kësaj babai veproi gjyqësisht kundër burrit për t'u rimbursuar, i cili ndërkohë ishte pasuruar në Xhamajkë dhe nuk kishte më asnjë qëllim të kthehej, dhe e fitoi çështjen.

Kështu, kush përmbush një detyrim ushqimor që rëndon mbi të tjerë, ka të drejtë të rimbursohet. Megjithatë për këtë, është thelbësore që sendet dhe shërbimet e furnizuara të përbëjnë *necessaries*, pra të jenë sende të nevojës së parë (ushqim, veshje etj) të domosdoshëm për të jetuar¹¹, të cilat ndërkohë nuk duhet të jenë sipër standartit të jetesës të subjekteve në fjalë.

Shumë e rëndësishme është që, kush ka furnizuar *necessaries*, të ketë vepruar me qëllimin për t'u rimbursuar (*the intent to charge*). Si në vendet e *Civil Law*, ashtu dhe *Common Law*, zakonisht përjashtohet konfigurimi i detyrimit për kthim, nëse kush ka hyrë në detyrimet e tjetrit, ka vepruar me shpirt liberaliteti të pastër, gjë që ndonjëherë prezumohet, përveç provës së kundërt, nga ekzistenca vetë e një raporti të ngushtë familjar.

Vëmendje meriton akoma *actio funeraria* dhe korresponduesi i vet angloamerikan. Që nga e drejta romake ishte njohur e drejta për atë që kishte paguar shpenzimet e varrimit të një tjetri, për t'u rimbursuar; flitej në këtë rast për *actio funeraria*. Në vendet e *Common Law* parashikohet diçka e ngjashme. Një nga rastet e para që kontinentalët do të cilësojnë gjerim i punëve, në të cilat juristët angloamerikanë kanë arritur të konfigurojnë një detyrim për kthim, përbëhet pikërisht nga shpenzimet e kryera për varrimin e një personi tjetër. Kushdo që ka paguar për varrimin e një tjetri, në fakt mund të veprojë kundër të tretëve eventualë ose personave të tjerë të detyruar për varrimin, që të rimbursohet. Detyrimi për të varrosur të vdekurit, njësoj si ai për të furnizuar *necessaries* fëmijëve apo gruas, në fakt konsiderohet një detyrë e vendosur në radhë të parë në interes publik, me pasojën që asnjë lloj ndalimi i të interesuarit, nuk është i përshtatshëm për të penguar lindjen e një përgjegjësie për kthim

6. Ruajtja e pronësisë së tjetrit

Një tjetër grup rastesh që në kontinent përbën gjerim të punëve të tjetrit, është kur ruhet në njëfarë mënyre prona e tjetrit. Shembulli më tipik është ai i një fqinji, i cili në një situatë energjence shuan një zjarr ose kryen punime urgjence, në mungesë ose gjithsesi në pamundësi që të bëhen personalisht nga ana e pronarit.

Më e ndryshme paraqitet ndërkohë situata në vendet e *Common Law* ku, për motive që dimë, kush vepron pa *authority* të të interesuarit, parimisht, nuk mund të paraqesë asnjë pretendim për kthim. Shumë ilustrative në këtë drejtim shfaqet çështja *Macclesfield Corporation v. Great central Railway* (1911), ku një *Canal Company*, në vazhdim të hapjes të një kanali që kalonte poshtë rrugës, kishte ndërtuar një urë për të lejuar qarkullimin. Me ligj, i takonte mirëmbajtja e rrugës. Pas disa vitesh ura filloi të japë shenja cedimi, me pasojën që administrata publike e riparoi me urgjencë në vend të saj. Pas kësaj u ngrit një padi për të marrë rimbursimin e shpenzimeve të kryera, por gjyqtarët e mohuan rimbursimin, edhe pse administrata publike kishte vepruar në një situatë emergjence dhe detyra për mirëmbajtjen e urës rëndonte shprehimisht me ligj mbi shoqërinë.

Neni 679 BGB, neni 2031 KCI

Nash v. Inman (1908): një student i pasur në Cambridge kishte porositur disa kostume tek një rrobaqepës dhe nuk i pagoi ato.

Rrobaqepësi paditi të atin, por e humbi çështjen. Bëhej fjalë për sende që nuk konsideroheshin *necessaries*.

Kush kryen shpenzime ruajtjen e sendeve të tjetrit, ose kur gjithsesi mirëmbajtja rëndon gjithsesi mbi të tjerë, nuk mund të paraqiten pretendime për kthim. Rregulla të ngjashme zbatohen edhe në raste të shpenzimeve të kryera nga një bashkëpronar në interesin e përgjithshëm. Në fakt, përjashtohet mundësia për të marrë ndarje të shpenzimeve të kryera për punime jo të rëna dakord më parë, edhe pse urgjente. Por nuk është gjithçka: kush vepron për të ruajtur sendet e tjetrit, mundet madje dhe të dënohet për të shpërblyer dëmet (*culpa est immiscere se rei ad se non pertinenti*). Në çështjen *Sherrin v. Haggerty* (1953), gjatë një përmbajtje, një person kishte ndërmarrë veprime për të shpëtuar shtëpinë e një fqinji. Kur e mori vesh, pronari i shtëpisë jo vetëm nuk e rimbursoi, por madje veprroi në *trespass* për të pretenduar shpërblimin e dëmit. Gjyqtarët përballë evidencës nuk mund të bënin gjë tjetër veçse të vendosnin në favor të pronarit, edhe pse konkretisht e kufizuan vetëm në një dollar shumën e dëmshpërblimit.

Kush vepron për të ruajtur pronën e tjetrit, rrezikon madje të dënohet me dëmshpërblim. Shumë kuptimplote duken edhe vendimet në fushën e gjetjes së objekteve të humbura. Në vendet e *Common Law*, gjetësi (*finder*) jo vetëm që nuk mund të paraqesë asnjë pretendim për kthim, por, kur refuzon kthimin e sendit, mund të dënohet të shpërblejë dëmin, si p.sh. në çështjen *Binstead v. Buck* (1773), ku një person kishte gjetur një qen të humbur dhe e kishte mbajtur vetë për një vit duke e ushqyer. Pronari jo vetëm nuk e pagoi për mbajtjen e qenit, por përballë refuzimit për kthim veprroi *in conversion*. Pra, as *finders* nuk kanë të drejtë të rimbursohen.

Në të vërtetë rigoroziteti me të cilin kuptohen këto parime, rezultojnë në planin praktik gjerësisht i ridimensionuar nga përjashtime të ndryshme të futura nga jurisprudenca angleze. Një nga përjashtimet e para që është njohur është e përbërë nga *maritime salvage*, shpëtimi i një anije në vështirësi. Bëhet fjalë për një institut të përpunuar nga gjykata e *Admiralty*, në bazë të të cilit nëse dikush ndërhyr në një moment vështirësie, ka të drejtë për një kompensim të garantuar nga një *equitable lien* mbi vetë anijen. Ky institut është kuptuar gjithmonë në mënyrë shumë të ngushtë dhe zbatuar vetëm në rastet e shpëtimit të anijeve të kryera në det të hapur. Në këtë optikë, shpëtimi i thjeshtë i një varke lundruese nuk mjafton të plotësojë kushtet e një *maritime salvage*.¹² Ndërkohë, përjashtohet gjithmonë zbatimi i një disipline të tillë për shpëtimit e jetëve njerëzore të kryera në det të hapur. Vetëm tani vonë, falë ndërhyrjeve legislative është shtrirë më në fund disiplina e *maritime salvage* edhe në favor të atij që ka shpëtuar dikë.¹³

Një kufizim tjetër i madh i përfshirë në konfigurimin tradicional të *maritime salvage*, konsiston në faktin që ajo mund të zbatohet vetëm kur veprimi i shpëtimit i referohet krejt anijes. Shpëtimi i thjeshtë i ngarkesës ose pjesë të anijes, nuk konsiderohet e mjaftueshme për këtë qëllim. Në rastet e shpëtimit të ngarkesës, mundet gjithsesi të vepronin institute të tjera, duke iu referuar në veçanti *bailment*. Në bazë të disiplinës së *bailment* është e qartë që kapiteni i anijes, përsa kohë depozitar i sendeve, është i detyruar të aktivizohet për të garantuar ruajtjen në rastet e emergjencës, me pasojën që një shmangia e tij eventuale, mund të sjellë përgjegjësi për dëmet. Megjithatë, kësaj përgjegjësie i bën kundërpeshë e drejta për t'u rimbursuar për shpenzimet e kryera. Kështu, nëse është e mundur të konfigurohet një raport i *bailment*, rezultojnë automatike edhe e drejta për rimbursim të shpenzimeve.¹⁴ Një përgjegjësi e tillë dhe e drejta korresponduese për rimbursimin e shpenzimeve, natyrisht nuk është e kufizuar vetëm për rastet e depozitës marine, por ka vend çdo herë që mund të konfigurohet një raport i *bailment*, edhe i heshtur. Kështu në një rast, është vendosur që një shoqëri hekurudhore, e cila pasi ka çuar një kalë në destinacion, kishte qenë e detyruar ta vendosë në, stallë përsa kohë nuk ishte paraqitur askush për ta marrë, kishte të drejtë të rimbursohet në zbatim të parimeve mbi *bailment*.¹⁵

Falë disiplinës së *bailment*, arrihet ndonjëherë të shmanget pengesa që rrjedh nga njohja e munguar në terma të përgjithshëm të një instituti të krahasueshëm me atë kontinental të gjerimit të punëve. Por ka dhe raste të tjera të ndryshme, në të cilat edhe juristët e *common law*, zakonisht arrijnë në konfigurimin e një detyrimi për kthim. Kujtohet një rast¹⁶, në të cilin një person kishte thirrur zjarrfikësit për të shuar një zjarr, por kishin mbërritur gabimisht zjarrfikësit e një tjetër distrikti. Zjarrfikësit pasi kryen shërbimin që nuk u takonte atyre, kishin kërkuar të paguheshin, duke e fituar çështjen. Juristët e *Common Law*, e kanë zakon të referojnë këtë vendim për të formuluar rregullin, në bazë të të cilit nëse shërbimi është kryer nga një subjekt publik, është më e lehtë të prezumohet qëllimi për t'u paguar. Megjithatë ky vendim përfaqëson një *unicum*. Pastaj nuk harrohet që, ndërhyrja e zjarrfikësve ishte kërkuar shprehimisht nga i interesuari dhe ne dimë që në vendet e *common law* nuk janë shtruar asnjëherë probleme të veçanta për të konfiguruar detyrimin për kthim në rastin kur veprimi është kërkuar (*acceptio*).

Rëndësi merr një përjashtim tjetër që është zhvilluar në fushën e *nuisance*. Nëse dikush vë re një situatë rreziku (p.sh. një mur të rrezikshëm) dhe merr përsipër ta lëvizë (*abatement of nuisance*), mund të pretendojë të dëmshpërblehet nga subjekti mbi të cilin rëndonte një detyrim i tillë. Tek çështja *Ghehardt v. Saunders* (1892), administrata publike kishte njoftuar qiramarrësin e një shtëpie për detyrimin për të eliminuar një situatë rreziku që ishte krijuar si pasojë e rrjedhjes së ujit. Qiramarrësi mori masa personalisht para se akoma të dinte që bëhej fjalë për një difekt të ndërtimit, ose një keqmbajtjeje të shtëpisë. Gjatë punimeve u saktësua që bëhej fjalë për një difekt struktural. Qiramarrësi i kërkoj pronarit të rimbursohet, duke fituar çështjen. Pra, kush merr masa personalisht për të eliminuar një burim rreziku për paprekshmërinë publike, mundet më pas të pretendojë që të rimbursohet nga personi, të cilit i takonte të merrte masa. Falë gjithë këtyre përjashtimeve, rregulli tradicional, në bazë të të cilit kush kryen një veprim jo të kërkuar, nuk mund të paraqesë asnjë pretendim për kthim, rezultojnë padyshim gjerësisht i ridimensionuar, duke sjellë, edhe në planin praktik që, ndryshimet mes vendeve të *Civil Law* dhe të *Common Law* të jenë shumë më të vogla sesa ai që mund të duket në pamje të pare për gjerimin e punëve të tjetrit. Fenomeni është veçanërisht i

Welles v. Gas Float Whitto (1897)

Goff dhe Jones, në veprën e tyre, f. 405

China Pacific SA v. Food Corporation of India (1982)

Great Norther Ry. Co v. Swaffied (1884)

Upton-on-Severn RDC v. Powell (1942)

dukshëm nga ana tjetër e oqeanit, në SHBA, ku jurisprudenca duket se tashmë ka pothuajse superuar paragjykimet tradicionale që ndalonin konfigurimin e një detyrimi për kthim në rastet që kontinentalët i cilësojnë si gjerim i punëve. I rëndësishëm për këtë duket vendimi *Wilder Grain Co. v. Felker* (1936): në ditët e para menjëherë pas vdekjes së titullarit të rritjes së pulave, një fermer mori masa të blente të gjithë grurin e nevojshëm për mbijetesën e pulave. Superuar emergjenca, kush kishte dorëzuar grurin, veprimi gjyqësisht kundër trashëgimtarëve për t'u paguar, duke fituar çështjen. Gjyqtarët konsideruan që do të kishte qenë kundër çdo lloj sensi drejtësie të vendosesh ndryshe. Megjithatë, një detyrim i tillë mund të lindë vetëm kur ndërhyrja është realisht e nevojshme dhe urgjente (*only where the need is immediate, absolute and imperative*).

Në konkluzione të ngjashme është arritur në një vendim tjetër të njohur të disa viteve më pas: *Berry v. Barbour* (1954): një ndërmarrje që ishte ngarkuar të kryente disa punime të riparimit të çatisë së një teatri, kreu dhe ca punime urgjente, jo të parashikuara, të bëra të domosdoshme nga një zjarr që kishte lindur gjatë punimeve. Përballë refuzimit të titullarit të teatrit të rimbursonte ndërmarrjen për punimet ekstra jo të rëna dakord, ndërmarrja veprimi gjyqësisht dhe e fitoi çështjen. Edhe në këtë rast, gjyqtarët arritën të superonin pengesën që rridhte nga mungesa e konsensusit të titullarit të teatrit, duke thirrur në konsideratë barazinë dhe drejtësinë thelbësore.

Në SHBA, instituti i gjerimit të punëve të tjetrit ka arritur tashmë qartësisht një nivel njohjeje dhe përpunimi sigurisht më të madh nga ai i verifikuar në Angli.

7. Rescuers

Një hipotezë e gjerimit të punëve, paralele me atë që sapo konsideruam, ka vend çdo herë kur dikush kryen një veprim shpëtimi të një personi në rrezik. Në vendet e *Civil Law*, doktrina pranon që, edhe shpëtimi i një jete njerëzore mund të plotësojë kushtet e gjerimit të punëve, me pasojën që, nëse veprimi i shpëtimit ishte realisht i nevojshëm, kush ka kryer përpjekjen, do të ketë të drejtë të rimbursohet të paktën për shpenzimet e kryera.

Si zakonisht, shumë e ndryshme shfaqet situata në vendet e *Common Law*, ku edhe në rastet e shpëtimit të jetëve njerëzore, jurisprudenca gjithmonë është treguar shumë ngurruese për të dhënë dëmshpërblim për shpëtuesin. Dikur, kush ndërhynte në një situatë rreziku për të shpëtuar një person tjetër dhe kishte nga ana e vet çënime, nuk mund as të pretendonte shpërblimin e dëmit nga përgjegjësi eventual i vetë situatës së rrezikut. Aktualisht kjo situatë është modifikuar, të paktën pjesërisht, me pasojën që jurisprudenca angloamerikane, siç ajo kontinentale, ka njohur gjerësisht të drejtën e *rescuers* të pretendojnë të paktën shpërblimin e dëmit.¹⁷ Shumë më i ngushtë vazhdon ndërkohë të jetë qëndrimi i juristëve të *common law* për çështjen nëse *rescuers* munden po kështu të pretendojnë ndonjë formë rimbursimi apo kompensimi për shërbimet e kryera. Në zbatim të parimeve të përgjithshme, zakonisht përjashtohet çdo formë dëmshpërblimi nëse ndihma e shpëtuesit nuk ishte të paktën kërkuar. Problemi natyrisht nuk merr shumë rëndësi praktike, meqë normalisht kush ndërhyr në një emergjencë, nuk e bën me qëllimin që më pas të paguhet, dhe nga ana tjetër kush shpëtohet, do të jetë shumë i kënaqur ta kompensojë shpëtuesin e e vet. Megjithatë, çështja mund të bëhet më aktuale në rastin e veprimit të kryer nga një mjek mbi një person pa ndjenja, dhe si i tillë jo në gjendje të kërkojë ndihmë, përfundimi i së cilës ndërkohë nuk është positive. Në këto raste, zgjidhja tradicionale ka qenë gjithmonë ajo që t'i mohohet mjekut çdo e drejtë që të kompensohet në njëfarë mënyre apo të rimbursohet. Duke munguar ndonjë lloj kërkesë apo pranimit të mëpasëm, nuk ishte në fakt e lehtë të arrihej në konfigurimin e një detyrimi për kthim. Megjithatë, situata ka filluar të lëvizë, dhe si zakonisht hapjet më të mëdha janë verifikuar në SHBA. Në një *leading case* të njohur amerikan, është njohur e drejta e një mjeku që ishte marrë me një pacient pa ndjenja, për t'u shpërblyer.¹⁸ Në një rast tjetër, të vendosur në Kanada, madje është arritur në konfigurimin e një të drejte për kthim në favor të një mjeku që kishte tentuar pa sukses të shpëtonte një vetvrasës.¹⁹ Duke u bërë fjalë për një tentativë vetvrasjeje, ishte evidente që veprimi i mjekut jo vetëm që nuk ishte kërkuar, por as nuk ishte i dëshiruar. Pavarësisht kësaj, jurisprudenca nuk hezitoi të konfiguronte një detyrim për kthim në favor të mjekut. Në Angli për të superuar rregullin tradicional u bë e nevojshme një ndërhyrje legislative. *Section 154 e Road Traffic Act e1970* i atribuon doktorit ose spitalit të drejtën për t'u paguar për kujdesje të bëra pacientëve pa ndjenja. Kështu, mund të thuhet që aktualisht në vendet e *Common Law*, të paktën mjekët kanë të drejtë të rimbursohen në njëfarë mënyre për shërbimet e kryera në favor të personave pa ndjenja, dhe si të tillë jo në gjendje të kërkojnë ndërhyrjen e tyre. Doktrina²⁰ uron që një e drejtë e ngjashme mund të njihet edhe në favor të jo profesionistëve që kryejnë veprime për të shpëtuar jetë njerëzore.

8. Gjerimi i punëve dhe *common law*

Si konkluzion mund të thuhet që, edhe pse juristët e *common law* nuk kanë përpunuar akoma formalisht në linjë të përgjithshme diçka të ngjashme me institutin kontinental të gjerimit të punëve të tjetrit, në planin praktik zgjidhjet angloamerikane nuk janë kaq të ndryshme nga ato kontinentale. Kështu diferencat shtrohen më tepër në nivel të parimeve dhe të ndërtimeve dogmatike së bashku, sesa të rregullave operative konkretisht të zbatuara. Nga njëra anë në fakt, në vendet e *Civil Law*,

P. Gallo, L'elemento oggettivo del tort of negligence, g. 171

Cotnam v. Wisdom (1907)

Matheson v. Smiley (1932)

Goff dhe Jones, Birks, Virgo etj.

instituti i gjerimit të punëve të tjetrit, edhe pse gjërësisht i pranuar parimisht, konkretisht kufizohet shumë në zbatimin e vet praktik nga kërkesa për të mbrojtur lirinë individuale. Në fakt, askush nuk mund të kërkojë të përdorë institutin e gjerimit të punëve të tjetrit, për t'i imponuar të tjerëve sende apo shërbime në kontrast me vullnetin e tyre. Vetëm kur verifikohet një situatë emergjence, dhe i interesuari nuk është personalisht në gjendje që të marrë masa personalisht (*absentia domini*), është e mundur të ndërhysh në punët e tjetrit dhe pastaj të rimbursosh për shpenzimet e kryera. Por vetë këto kërkesa mbrojtjeje të lirisë individuale, që në fakt rrethojnë shumë fushën e veprimit të gjerimit të punëve në kontinent, ndjehen në mënyrë akoma më intense në vendet e *Common Law*, në një pikë të tillë që çojnë parimisht në mohimin e çdo mundësie shpërblimi atij që ka furnizuar sende ose shërbime jo të kërkuara. Mungesa e kërkesës së veprimit përbën në fakt për juristët e *common law* njëfarë barriere vështirësisht të kapërcyeshme. Megjithatë, konstatohet se si në shumicën e rasteve, në të cilat konkretisht do të konfigurohet një gjerim i punëve të tjetrit në kontinent, edhe në vendet e *Common Law* konfigurohet një detyrim për kthim. Në disa raste, bëhet referim në institute sektoriale *si agency of necessity* ose *maritime salvage*, herë të tjera arrihen të njëjtat rezultate praktike përmes zbatimit të instituteve të tjera, si p.sh. *bailment*. Sektori në të cilin akoma sot qëndrojnë diferencat më të mëdha, përbëhet sigurisht nga pagimi i borxhit të tjetrit. Në vendet e *Common law*, kush shuan një borxh të tjetrit, nuk mundet pothuajse asnjëherë të paraqesë pretendime për kthim. Nuk mund të pretendohet kthimi i shumës direkt nga kreditori përse kohë, duke munguar gabimi, nuk mund të shtrohet problemi i pagimit të padetyruar, nga ana tjetër nuk mund të veprohet as kundër debitorit për t'u rimbursuar, përse kohë që juristët e *common law* janë shumë më ngurrues se kontinentalët që të lejojnë të tjerët të zëvendësohen jo vetëm në anën pasive, por dhe në atë aktive të marrëdhënies detyimore. Kështu synohet të shmanget që, një i huaj mund të hyjë në marrëdhënien detyimore, duke zëvendësuar kreditorin përmes pagimit të borxhit. Rastet e vetme, në të cilat pranohet rimbursimi (*reimbursement*) i shumës së derdhur janë ato ku, një i tretë i huaj ka ndërhyrë në radhë të parë për të mbrojtur një interes të vetin pasuror.

Ndërkohë, shumë më të vogla janë diferencat që shfaqen në rastet e tjera të gjerimit të punëve. Kush përmbush një detyrim ushqimor të tjetrit ka, në fakt, pak a shumë të njëjtat mundësi për t'u rimbursuar në kontinent dhe në vendet e *Common law*. Një diskutim i ngjashëm mund të përsëritet për shpëtimin e pronës së tjetrit. Në Angli, falë veprimit të një sërë institutesh, arrihet në shumicën e herëve t'i garantohet ndonjë formë shpërblimi gjeruesit. Akoma më e qartë është situata në SHBA, ku jurisprudenca nuk ka hezitur të njohë haptaz të drejtën atij që ka ndërhyrë në një situatë emergjence për t'u rimbursuar. E ngjashme është situata në fushën e shpëtimit të jetëve njerëzore. Jurisprudenca angloamerikane duket tashmë se e ka kapërcyer pothuajse krejtësisht paragjykimin që, një kohë ndalonte çdo formë shpërblimi në këtë sektor. Mund të arrihet në konkluzionin që, duke bërë përjashtim vetëm për sektorin e pagimit të borxhit të tjetrit, në vendet e *Common Law*, situatë nuk është aq e ndryshme nga ajo kontinentale.

E vërtetë është që, pak a shumë në të njëjtat raste, në të cilat kontinentalët do të konfigurorin një gjerim të punëve të tjetrit, edhe juristët e *Common Law* arrijnë të pranojnë një detyrim për kthim. Diferencat më të mëdha janë më shumë të natyrës sistematike dhe të inkuadrimit: ndërkohë që kontinentalët janë mësuar tashmë të dallojnë qartë mes pagimit të padetyruar, begatimit pa shkak dhe gjerimit të punëve të tjetrit, nuk ndodh kështu në vendet e *Common Law*, ku këto tre institute trajtohen bashkarisht në kuadrin e *law of restitution*. Të njëjtat mjete që operojnë në fushën e pagimit të padetyruar (*quantum meruit, quantum valebat* etj), operojnë edhe në të gjitha rastet e tjera ku begatimi i detyrohet një sjelljeje të të varfëruarit, dhe kështu në rastet e begatimit të detyruar dhe në fushën e gjerimit të punëve. Të gjitha këto raste kanë në fakt, sigurisht, diçka që në të njëjtën kohë i bashkon dhe i ndan nga rastet e begatimit që i detyrohen sjelljes së të begatuarit. Tani vonë juristët e *Common Law* kanë treguar njëfarë interesimi për sistematikën kontinentale, me pasojën që dallohet një hyrje progresive e tre instituteve familjare për kontinentalët, pagimit të padetyruar, begatimit pa shkak dhe gjerimit të punëve të tjetrit. Megjithatë, doktrina kontinentale pyet deri në cilën pikë kjo mund të përfaqësojë një progres efektiv, dhe jo një faktor bezdisje dhe konfuzioni të mëtejshëm në një fushë që është në vetvete një nga më konfuzet dhe të ndërlikuarat e së drejtës angloamerikane.

ANALIZË E KONKURRUESHMËRISË SË SISTEMIT BANKAR NË SHQIPËRI SIPAS MADHËSISË SË BANKAVE

EUGEN MUSTA, DOKT.

Universiteti European i Tiranës, Fakulteti Ekonomik, Profili Financë
e-mail: eugen.musta@hotmail.com

ELONA SHEHU, DOKT.

Universiteti European i Tiranës, Fakulteti Ekonomik, Profili Financë
e-mail: elona.shehu@uet.edu.al

ABSTRAKT

Vendi ynë karakterizohet nga një sistem financiar i brishtë dhe jo shumë i zhvilluar. Ky studim i bazuar në madhësinë e bankave, ngrihet në dy shtylla kryesore: konkurrueshmëria dhe performanca. Studimi synon ndarjen e sistemit bankar në tre grupime sipas madhësisë së bankave. Qëllimi është identifikimi i bankave të mëdha për të cilat do të trajtohet përveç performancës dhe konkurrueshmërisë, edhe fenomeni “Too Big To Fail” (cilësuar si TBTF më tej) si edhe bankave të vogla të cilat duke qënë se kanë peshë më të vogël mendohet se performojnë më dobët brenda industrisë bankare. Variablat e kontrollit mbi të cilat do të gjykohet ndarja e bankave janë: asetet totale, totali i aseteve si përqindje e tregut bankar, totali i aseteve në raport me GDP-në dhe ROA. Për të analizuar konkurrueshmërinë studimi mbështetet në indeksin Herfindahl-Hirschman (HHI), i cili mat shkallën e përqendrimit të bankave në treg. Një tregues i lartë i përqendrimit, konstaton një nivel konkurrueshmërie të ulët dhe për pasojë evidenton gjurmë të monopolizimit të tregut. Sipas analizës së këtij treguesi, rezulton se industria e bankingut në Shqipëri ka një nivel të moderuar konkurrueshmërie, dhe për pasojë tregu nuk konsiderohet i monopolizuar. Përsa i përket shtyllës së dytë të analizës sonë, konstatohet se bankat e mëdha kanë një nivel performancë më të lartë se bankat e vogla. Pra bankat e mëdha duke qënë më eficiente në terma të performancës e udhëheqin tregun bankar, dhe për pasojë lënë një shteg diskutimi përse i përket fenomenit Too Big Too Fail. Ky punim ka një kontribut të rëndësishëm në kuadër të debateve dhe diskutimeve bashkëkohore akademike në fushën e financës.

Fjalë kyç: *Sistem bankar, performancë, konkurrueshmëri, monopolizim, indeksi Herfindahl Hirschman*

1. Hyrje

Nisur nga debati akademik mbi mënyrën e trajtimit të sistemit bankar gjatë krizave të fundit financiare, propozimet mbi sistemin rregullator, kërcënimin që vjen prej bankave të cilësuar *Too Big To Fail* si edhe shkallën e monopolizimit të sistemit bankar—ky punim synon të analizojë industrinë bankare në Shqipëri duke klasifikuar bankat e nivelit të dytë për nga madhësia duke identifikuar bankat potenciale për t’u trajtuar si *Too Big To Fail* (në vijim referuar TBTF). Punimi është i ndarë në dy akse themelore, konkurrueshmëria dhe performanca.

Konkurrenca është një aspekt tejet i rëndësishëm përse i përket zhvillimi ekonomik të një vendi. Rritja e konkurrueshmërisë stimulon rritjen e sektorëve të tjerë të ekonomisë por mbi të gjitha është një katalizator për rritjen e efikasitetit ekonomik. Analizimi i këtij treguesi është shumë i rëndësishëm përse i përket vendeve në zhvillim. Duke qëndruar brenda kornizës teorike është konstatuar se për vendet në zhvillim preferohet një nivel i moderuar i konkurrueshmërisë, pasi pasja e një shkalle të lartë konkurrueshmërie, krijon nxitje për bankat që të marrin më shumë rrezik; por duke rritur shkallën e ekspozimit ndaj riskut, rrezikohet performanca. Një arsye përse konkurrueshmëria është fokusi kryesor i këtij studimi lidhet edhe me monopolizimin si fenomen tepër të diskutuar në qarqet akademike dhe jo vetëm. Duke analizuar indikatorët e përqëndrimit dhe konkurrueshmërisë, mund të induktohet një konkluzion në lidhje me monopolizimin e sistemit bankar në Shqipëri.

Analiza e performancës bëhet sipas grupimit të bankave, duke synuar të evidentohet nëse bankat e mëdha performojnë më mirë se bankat e vogla. Konstatimi se bankat e mëdha performojnë më mirë dhe për pasojë kanë efikasitet më të lartë se bankat e vogla, le hapësira diskutimi për prezencë të fenomenit TBTF. Prania e këtij fenomeni, përbën një kërcënim për sistemin bankar në Shqipëri, pasi rrit se tepërmi shkallën e përqëndrimit të tregut dhe mund të përbëjë një kërcënim edhe në terma të konkurrueshmërisë. Kjo konstaton ekzistencën e një marrëdhënie pozitive midis performancës dhe madhësisë së bankave.

Studimi i performancës edhe i konkurrueshmërisë krijon një tablo të qartë të monopolizimit dhe efektivitetit të tregut bankar në Shqipëri. Rritja e konkurrueshmërisë rrit efikasitetin e industrisë bankare dhe jo vetëm. Por duhet theksuar se niveli i lartë i konkurrueshmërisë ka dy anë të medaljes; bankat në momentin që ndodhen në një treg ekstremisht konkurrues, tentojnë të marrin përsipër shumë risk, në mënyrë që të udhëheqin tregun; marrja përsipër e riskut në këto nivele, çënon dukshëm efikasitetin. Prandaj tregu, ka nevojë për një nivel të moderuar konkurrence ose konkurrueshmërie të lartë por të ‘kruar’ përse i përket kuadrin rregullativ për menaxhimin e riskut.

Studimi bazohet në analizën e të dhënave të një harku kohor prej 10 vitesh, duke përfshirë segmentin kohor 2004-2013. Me të dhënat e disponuara është trajtuar shkalla e monopolizimit të sektorit bankar, niveli i konkurrueshmërisë, ndikimi i futjes në treg të bankave të reja, ndryshimet që vërehen në zhvillimin në rritje apo në rënie të bankave të ndryshme dhe si këto ndryshime kanë ndikuar në diversifikimin e tregut.

Në seksionin e parë të këtij punimi trajtohet qëllimi dhe objektivat e punimit, duke vijuar më tej me pyetjen kërkimore, shtrimin e hipotezave dhe metodologjinë e përdorur. Në seksionin e tretë të punimit trajtohet analiza e të dhënave, për të arritur në pjesën e fundit ku paraqiten konkluzionet e arritura si dhe rekomandimet përkatëse.

2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë strukturën e sistemit bankar në Shqipëri si edhe efektin e madhësisë së bankave në shkallën e performancës dhe konkurrueshmërisë së tyre. Për të analizuar këtë fenomen studimi bazohet në indeksin e përqëndrimit *Herfindahl-Hirschman*, krahasimit të performancës ndërmjet bankave të madhësive të ndryshme dhe analizën e fenomenit TBTF të sistemit tonë bankar.

Në kuadër të objektivave, ky punim synon: *së pari* të përshkruajë në rend kronologjik zhvillimin e sistemit bankar në Shqipëri, duke u bazuar edhe në eksperiencat e shkrires dhe bashkimit të bankave (njohur si *Merger and Acquisition*); *së dyti* analizohet sistemi bankar në kuadër të madhësisë së bankave, duke i klasifikuar ato në tre grupe sipas peshës përkatëse të secilës bankë, në raport me peshën e sistemit. Në këtë kontekst studiohet prania e fenomenit TBTF, bazuar në mundësinë e shfaqjes së riskut sistematik; *së treti*, punimi identifikon shkallën e monopolizimit të sektorit bankar duke marrë si indikator kryesor indeksin e përqëndrimit, të njohur në literaturën ndërkombëtare si HHI (*Herfindahl-Hirschman index*). Nëpërmjet këtij indikatorit analizojmë nivelin e konkurrueshmërisë si edhe mundësinë e monopolizimit në rast shkrires dhe bashkimi të bankave; *së katërti* studimi krahason shkallën e performancës midis grupeve; *së fundmi*, në konkludim të punimit, në varësi të performancës së bankave të vogla propozohet mundësia e specializimit sektorial apo gjeografik si edhe mundësia e bashkimit, me qëllim rritjen e shkallës së konsolidimit të tyre në tregun bankar.

3. Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Ky studim—ashtu siç u përmend edhe më lart—është ngritur mbi dy shtylla kryesore: konkurrueshmëria dhe performanca. Ka shumë debate akademike në lidhje me performancën e bankave dhe të sistemit në tërësi, por analiza jonë është një qasje krahasuese midis performancës së bankave të mëdha dhe atyre të vogla. Në këtë kontekst ngrihet pyetja kërkimore nëse bankat e mëdha performojnë më mirë se bankat e vogla. Duke analizuar performancën sipas grupeve, është trajtuar

Shiko Aneksi B

performanca brenda grupeve dhe ndërmjet tyre. Për t'iu përgjigjur pyetjes kërkimore, hipotetizohet se:

H₁: Bankat e mëdha G3 kane shkallë performance më të lartë se bankat e vogla G1.

Shtylla tjetër tejet e rëndësishme është konkurrueshmëria, e cila trajtohet në kuadër të monopolizimit të industrisë bankare në Shqipëri. Në tentativë për t'iu përgjigjur pyetjes kërkimore nëse industria bankare në Shqipëri është e rrezikuar nga monopolizimi, ky studim ngre hipotezën e dytë si vijon:

H₂: Rritja e peshës specifike të bankave të grupit të 3, ul shkallën e konkurrueshmërisë brënda industrisë bankare në vend.

Për të kryer këtë studim, janë përdorur të dhëna nga raportet vjetore të mbikqyrjes së Bankës së Shqipërisë dhe raportet vjetore të Shoqatës Shqiptare të Bankave. Punimi studion ndryshimet e 10 viteve të fundit të indikatorëve të tillë si numri i bankave në sistem, peshat specifike që ato zënë për nga madhësia, kthimi mbi asetet dhe indikatorin e përqëndrimit HHI. Analiza e kryer është përshkruese dhe analitike duke identifikuar njëkohësisht edhe shkaqet e fenomeneve të vërejtura. Në konkludim të analizës do t'i jepet përgjigje pyetjes kërkimore dhe vërtetësisë së hipotezës.

4. Rishikim Literature

Sipas Claessens and Laeven (2005), konkurrenca si një aspekt i rëndësishëm për sistemin bankar ndikon eficiencën dhe cilësinë e produkteve të ofruara. Niveli i konkurrencës në sistemin bankar ndikon edhe sektorë të tjerë të ekonomisë. Kështu, evidencat empirike tregojnë se një nivel më i lartë konkurrence në sistemin bankar çon në rritje më të shpejtë të sektorëve të tjerë të ekonomisë, që mbështeten në financimet nga sistemi bankar. Në mbështetje të të njëjtës tezë është edhe studimi i Deidda dhe Fattouh (2002) të cilët sugjerojnë se vendet në zhvillim kanë nevojë për një sistem bankar me konkurrencë më të lartë, për të nxitur rritjen ekonomike. Ndërsa, sipas Vives (2001) shkalla e lartë konkurrencës, motivon bankat për të marrë përsipër më shumë risk duke rritur kështu mundësinë e falimentimit. Si rrjedhojë, për vendet në zhvillim do të ishte më i përshtatshëm një sistem bankar me konkurrencë të moderuar, duke qënë se për to është më e vështirë të ruajnë stabilitetin e tij, në prani të një konkurrence të lartë. Pra literatura konstaton që konkurrueshmëria e sektorit bankar është një aspekt i rëndësishëm që ndikon në zhvillim, por pyetja që lind është se si e masim nivelin e saj?

Për të matur konkurrueshmërinë në literaturë gjenden disa instrumentë të ndryshëm ndër të cilët vlen të përmenden disa prej tyre. Bikker dhe Haaf (2002) analizojnë 10 të tillë si indekset CRk, HHI, HTI, RI, ÇI, HKI, U, Hm, Ha, E duke konkluduar se indeksi HHI (*Herfindahl-Hirschman index*) është indeksi më i përdorur në praktikë nga shumë shtete për matjen e konkurrueshmërisë së tregut. Në SHBA p.sh. indeksi merret si matës i impaktit që një M&A e bankave mund të ketë në konkurrueshmërinë e tregut dhe trajtohet më pas me ligjet e anit-trust-it.

Referuar Ferreira (2012), shohim se indeksi i përqëndrimit (HHI) përlllogaritet si shuma e katrorëve të peshës së tregut për secilën bankë. Ndërsa për interpretimin e vlerave të indeksit ekzistojnë standarte të ndryshme. Në rastin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sic përshkruhet në Guidën për Shkrijet Horizontale (2010) të Departamentit Amerikan të Drejtësisë, klasifikimi i tregjeve për indeks më të ulët se 1500 pikë tregu është i pa përqëndruar, për indëkse ndërmjet 1500 deri në 2500 pikë tregu shfaq përqëndrim të moderuar, ndërsa për vlera mbi 2500 pikë tregjet shfaqin përqëndrim të lartë.

Edhe për vendet e Bashkimit Europian sipas rregullores së botuar ne Fletoren Zyrtare të Bashkimit Europian (2004/C), niveli i përgjithshëm i përqëndrimit të një tregu mund të ofrojë informacion të dobishëm mbi situatën e konkurrencës. Për të matur nivelin e përqëndrimit Komisioni përdor indeksin HHI. Sipas po të njëjtit dokument, nëse indeksi i përqëndrimit është nën nivelin e 1000 pikëve, tregu gëzon konkurrencë të plotë dhe nuk shihet e nevojshme të ndërhyet për përmirsimin e saj. Nëse ky indeks varion midis vlerave 1000 dhe 2000 pikë atëherë raporti konkludon për një nivel konkurrueshmërie të moderuar dhe nevoja për ndërhyrje do të shfaqet vetëm nëse delta e ndryshimit në indeks është më e madhe se 250 pikë. Në rast se indeksi HHI tejkalon vlerën 2000 pikë tregu ka përqëndrim të lartë e për pasojë nivel konkurrueshmërie të ulët.

Madhësia e disa bankavë mbi të tjerat si dhe rëndësia e tyre në ekonominë e një vëndi bëri që vëmëndja drejt tyre të shtohet dhe fati i tyre të trajtohet në analiza dhe debate të shumta akademike. Ky fenomen u vendos në qëndër të vëmëndjes sidomos pas krizës financiare të vitit 2008 kur frika për një dështim të tregut bëri që qeveritë e shumë shteteve të ndërhyenin për të shpëtuar këto banka dhe cmimi që u pagua rezultoi shumë i kripur. Këto ngjarje provuan sërish ekzistencën e bankave, dështimi i të cilave nuk është një alternativë e pranueshme pra, *To Big To Fail*. Megjithëse nuk ekziston një përkufizim i saktë se si të identifikojmë një bankë TBTF, literatura n'a sugjeron disa indikatorë karakterizues. Sipas Labonte (2014), institucionet financiare janë konsideruar si TBTF kur politikëbërësit gjykojnë që dështimi i tyre mund të shkaktojë dëmtime të papranueshme të sistemit financiar. Në vijim autori thekson se një firmë mund të konsiderohet TBTF për shkak të madhësisë së saj ose për shkak të rëndësisë në një segment të caktuar të tregut financiar.

Barth, Prabha dhe Swagel (2012) analizojnë rastin e shpëtimit të Bankës Pensilvania, e cila në vitin 1980 ishte e 23-ta bankë për nga madhësia në vend. Agjensia Federale e Sigurimit të Depozitave konsideroi që mbyllja e një banke të këtyre përmasave do të sillte dëme serioze në tregun financiar. Ky rezultat të jetë edhe rasti i parë që Agjensia Federale konsideron një insitution financiar si TBTF. Barth et.al (2012) më tej specifikon dy indikatorë për klasifikimin e bankave si TBTF, madhësia e asetëve dhe madhësinë e asetëve në raport me PBB-në. Brewer dhe Jagtiani (2007) po ashtu theksojnë se madhësia është indikator


më domethënës për përcaktimin e bankave TBTF. Në vijim ata konkludojnë se bankat e nivelit të vogël ose të mesëm kanë stimuluj për të bërë M&A në mënyrë që të klasifikohen si TBTF, e për këtë ata janë të gatshëm të paguajnë një prim shtesë.

Për të matur performancën e bankave, literatura n'a orienton në indikatorë të ndryshëm siç mund të jenë ROA, ROE, ROD etj. Në një studim krahasimor Bikker (2009) konkludon se indexi i kthimit mbi asetet (ROA) është indikator i suksesshëm i matjes së performancës. Ky konkluzion përforcohet nga autori edhe me rezultate të njejtë të marra nga studime të tjera të bëra nga ai me grupe të dhënash dhe periudha të ndryshme të analizuar përkatësisht në studimet e Bikker dhe Bos (2008) e Bikker dhe Bos (2005).

5. Analiza e të dhënave

Ndryshimet radikale politiko-ekonomike të fillimit të viteve '90, në Shqipëri u shoqëruan edhe me ndryshime rrënjësore të sistemit bankar në vënd, i cili deri në atë kohë ishte një sistem me një nivel, tipar ky dallues i ekonomive të centralizuara. Në vitin 1992 miratimi i ligjit «Për Bankën e Shqipërisë» dhe ligjit «Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë», shënoi dhe kalimin në sistemin bankar me dy nivele. Banka e Shqipërisë u krijua si bankë e nivelit të parë, pra bankë qendrore e vendit së cilës j'u dhanë kompetencat ligjore për licencimin e bankave të nivelit të dytë si dhe funksionin e mbikëqyrjes bankare. Liberalizimi i tregut bankar në shqipëri u ndoq me rritjen e numrit të bankave dhe origjinës së kapitaleve të tyre. Ky proces ndodhi shkallë-shkallë dhe me forma të larmishme si marrëveshje të ndryshme, procese të licensimit të pastër apo edhe episode shkrirjesh (M&A).

GRAFIKU NR.1: ECURIA E NUMRIT TË BANKAVE NË SHQIPËRI



Burimi: Grafiku është ndërtuar nga autorët.

Kalimi në sistemin bankar me dy nivele në vitin 1992 e gjen Shqipërinë me 6 banka të nivelit të dytë, katër prej të cilave janë me pronësi shtetërore dhe dy të tjerat me pronësi të përzier. Në vitin pasardhës kemi shkrirjen e parë midis Bankës Kombëtare Shqiptare dhe Bankës Tregtare Shqiptare. Si pasojë e këtij procesi u krijua Banka Kombëtare Tregtare (BKT), e cila ishte në pronësi të plotë të Ministrisë së Financave për t'u privatizuar më vonë në vitin 2000. Privatizim ky më i madhi deri në atë moment, për të vijuar më tej me privatizimin e Bankës së Kursimeve në vitin 2004 që do të shënonte edhe fundin e pronësisë dominuese të shtetit mbi sektorin bankar në Shqipëri.

Në këtë kohë në tregun bankar shqiptar operonin 16 banka, numër ky që mbetet i njëjtë edhe sot. Megjithëse numri i bankave nuk ndryshon, periudha në vazhdim është e mbushur me ndryshime dinamike në strukturën e posedimit të aksioneve të bankave të ndryshme, proces ky që shpesh është shoqëruar edhe me ndryshime të emrave tregtarë të bankave. Midis ndryshimeve me të rëndësishme të ndodhura gjatë kësaj periudhe në lidhje me pronësinë e këtyre bankave, mund të përmendet shkrirja e Bankës Italo-Shqiptare me Bankën Amerikane të Shqipërisë si dhe blerja e kësaj të fundit nga Grupi Intesa San Paolo. Gjithashtu vlen të përmendet edhe rënia në peshën specifike brënda sistemit e ish-Bankës së Kursimeve (sot Raiffeissen) nga rreth 60% të peshës totale të sektorit në 2004 në 23% në fund të vitit 2013.

Analizë e madhësisë së bankave sipas grupeve

Në analizën tonë ne ndalemi të vëzhgojmë sjelljen brënda grupeve dhe me pas trajtojmë sjelljen midis grupeve. Duke analizuar raportet e Bankës së Shqipërisë vihet re se pikërisht në këtë kohë, pra në fund të procesit të privatizimit, Banka e Shqipërisë në vitin 2007 numri i bankave në sistem shkon në 17-te, por zbret përsëri në 16-te vitin pasardhës pas shkrirjes së Bankës Italo-Shqiptare me Bankën Amerikane të Shqipërisë

në analizat e saj e sposton vëmendjen nga analizat mbi pronësinë në ato mbi peshën specifike që zë secila bankë në raport me industrinë, duke i klasifikuar kështu bankat e nivelit të dytë në tre grupime, përkatësisht në grupin e parë përfshihen bankat me peshë specifike më të vogël se 2% e peshës totale të sistemit; në grupin e dytë bankat me peshë specifike 2%-7%, dhe në grupin e tretë bankat me peshë më të madhe se 7% e peshës së industrisë.

GRAFIKU NR.2: GRUPIMI I BANKAVE TË NIVELIT TË DYTË NË SHQIPËRI SIPAS PESHËS




Burimi: Grafiku është ndërtuar nga autorët

Të dhënat e diskutuara në këtë paragraf janë përmbledhur në skemën e mësipërme. Në vijim të këtij punimi bankave të grupit G3 do t'i referohemi si banka të mëdha, ndërsa bankave të grupit G1 do t'i referohemi si banka të vogla. Në fokus të analizës janë bankat e mëdha dhe ato të vogla. Në aneksin në fund të këtij punimi gjendet tabela e detajuar e klasifikimit të bankave.

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten në formë të përmbledhur bankat e grupit G1, pesha specifike e të cilave është më e vogël se 2% e peshës totale të sistemit.


GRAFIKU NR.3: ANALIZË E PESHES SPECIFIKE PËR BANKAT E VOGLA



Burimi: Grafiku është ndërtuar nga autorët

Në ndryshim nga sjellja tipike e grupit në grafik vihet re një tendencë e theksuar në rritje e peshës së bankës Veneto, e cila në vitin 2009 shfaq një shkëputje nga pasha totale e grupit e cila mund ti atribuohet ndryshimit të administrimit të ndodhur mbas blerjes së aksioneve të saj një viti më parë nga Veneto Banka Holding . Kjo tendencë në rritje mbi mesataren e grupit vazhdon deri në fund të vitit 2013, duke krijuar premisa që Banka Veneto, të kalojë pragun minimal prej 2% të peshës së sektorit, duke kaluar në grupin e dytë. Po ashtu, me të njëjtin trend performon edhe Banka e Parë e Investimeve e cila po ashtu ka pësuar një ndryshim strukturor në vitin 2007, kur mori licencën për të operuar si bankë.


GRAFIKU NR.4: ANALIZË E PESHES SPECIFIKE PËR BANKAT E MESME



Burimi: Grafiku është ndërtuar nga autorët

Bankat që bëjnë pjesë në grupin e dytë, sic mund të evidentohet edhe nga grafiku i mësipërm kanë një performancë të qëndrueshme të peshës së tyre në sektor. Për t'u theksuar në këtë paraqitje grafike është rasti i filialeve të dy bankave greke (banka Alpha dhe NBG), të cilat pas vitit 2008 që përkon me shpërthimin e krizës financiare globale, patën një rënie të dukshme në peshën e tyre në raport me sistemin. Por ndërkohe i gjithë peisazhi ndryshon pas vitit 2012 kur këto të fundit u detyruan të ndryshojnë statusin e tyre juridik nga degë të bankave në banka tregtare të licensuara si të tilla. Kjo lëvizje paralele e performancës së këtyre bankave me kapital grek, pasqyrojnë dukshëm efektin e riskut sistematik që i bën ata të lëvizin në trajektore të ngjashme, ndryshe nga bankat e tjera brenda këtij grupi.

GRAFIKU NR.5: ANALIZË E PESHES SPECIFIKE PËR BANKAT E MËDHA




Burimi: Grafiku është ndërtuar nga autorët

Për t'u theksuar në grupin e tretë është fakti se 3 bankat më të mëdha në sistem, zotërojnë më shumë se 55% të industrisë bankare në Shqipëri ose në terma relative me Produktin e Brendshëm Bruto, 50% të PBB-së. Vihet re se dy bankat më të mëdha janë Raiffeisen dhe BKT. Në fillim të analizës sonë, rreth vitit 2007, Raiffesien udhëheq grupin, me mbi 18% differencë krahasuar me Bankën Kombëtare Tregtare. Në fund të vitit 2013, vihet re një balancim në peshë midis dy aktorëve kryesorë të tregut bankar në Shqipëri, ku secila zë përafërsisht rreth 22% të tregut.

Konkurrueshmëria

Mbasi analizuam peshën specifike që mban secila bankë në sistem si dhe tiparet dhe tendencat që paraqet secili grup pyetja që lind është se çfarë ndikimi ka ky përqëndrim në nivelin e konkurrueshmërisë së sistemit dhe si parashikohet e ardhmja. Për të kryer këtë analizë me të dhënat e peshës specifike të bankave ndër vite është ndërtuar një grafik. Grafiku i mëposhtëm paraqet indeksin e përqëndrimit Herfindahl-Hirschman, i cili është cilësuar nga Bikker dhe Haaf (2002) si një nga indikatorët kryesorë për matjen e konkurrencës në treg. Indeksi matet si shuma e katrorëve të peshës specifike të secilit aktor në industri. I njëjti indeks përdoret edhe nga Banka e Shqipërisë për të vlerësuar shkallën e konkurrencës në tregun vendas. Sipas Këshillit të Europës (2004) nëse indeksi i përqëndrimit është nën nivelin e 1000 pikëve, tregu gëzon konkurrencë të plotë. Nëse ky indeks varion midis vlerave 1000 dhe 2000 pikë atëherë raporti konkludon për një nivel konkurrueshmërie të moderuar dhe në rast se indeksi HHI tejkalon vlerën 2000 pikë tregu ka përqëndrim të lartë e për pasojë nivel konkurrueshmërie të ulët. Në grafikun e mëposhtëm vihet re një tendencë e përgjithshme rënëse e përqëndrimit të tregut, e cila përkthehet në një përmirësim të konkurrencës së sektorit bankar. Nga një vështrim më i detajuar i paraqitjes grafike vihet re se në dy segmente kohore, përkatësisht nga viti 2007 deri në vitin 2010 dhe nga viti 2011 e në vazhdim ka pasur një rënie të përgjithshme të nivelit të përqëndrimit të tregut.

GRAFIKU NR.6: ECURIA E INDEKSIT HERFINDAHN HIRSCHMAN




Burimi: Grafiku është ndërtuar nga autorët

Ndërkohë që nga viti 2010 deri në vitin 2011 indeksi HHI ka pësuar një rritje të lehtë që i atribuohet rritjes së peshës specifike të Bankës Kombëtare Tregtare duke krijuar një përqendrim më të lartë të dy bankave më të mëdha që së bashku gjatë atij viti zënë 46% të peshës totale. Rënia prej rreth 250 pikësh e indeksit përgjatë gjithë harkut kohor të analizuar i atribuohet sipas analizës sonë, balancimit të peshës së dy bankave më të mëdha, Raiffeissen dhe BKT, përkatësisht tendencës në rritje të Bankës Kombëtare Tregtare dhe asaj në rënie të Raiffeisen. Ky balancim ndihmon në uljen e përqendrimit të tregut dhe rritjen e konkurrueshmërisë.

Performanca e bankave sipas grupeve

Në vazhdim të analizës tonë ne i jemi përgjigjur pyetjes nëse madhësia e bankës pra peshë specifike që ajo zë në sistem e ndikon performancën. Për t'ju përgjigjur kësaj pyetje kemi ruajtur ndarjen e bankave në grupe sipas kriterëve që kemi përmendur më lart. Si indikator matës për matjen e performancës është marrë indeksi i Kthimit mbi Asetet (ROA) që sipas Bikker (2009) dhe Bikker dhe Bos (2008) është indikator i më i suksesshëm i matjes së performancës.

GRAFIKU NR.7: ECURIA E PERFORMANCËS SIPAS GRUPIMIT TË BANKAVE NË SHQIPËRI



Burimi: Grafiku është ndërtuar nga autorët

Nga grafiku mund të vihet re qartë se bankat e grupit të 3, pra bankat e mëdha kanë një performancë dallueshëm me të mirë nga bankat e grupit të 1, që përgjithësisht performojnë me keq.

Nëse do të ndaleshim në një analizë më të detajuar të performancës brënda grupeve, Grupi i parë ka një performancë kryesisht negative ose me vlera të vogla positive. Nga krahasimi që mund të bëjmë me të dhënat e mëparshme vihet re se ekziston një relacion midis performancës më të mirë në krahasim me grupin dhe rritjes në peshë të dy bankave Veneto dhe First Investment Bank. Në Grupin e 2 shohim se trendi në performancë është më i stabilizuar sic është edhe luhatja e peshës specifike të komponentëve të grupit. Në Grupin e 3 shohim një vlerë positive të mesatares së indikatorit që është dukshëm më e lartë se ajo e dy grupeve të tjera.

Relacioni i venë re edhe me grupet e tjera ekziston edhe në këtë grup duke dhënë një lidhje të dukshme midis madhësisë dhe performancës. Përrjashtim përbën vetëm rasi i Bankës Tirana e cila ka pësuar një rënie të madhe duke filluar nga viti 2009 duke zbritur në vlera negative në vitin 2012. Kjo rënie e dukshme në performancës është shoqëruar me një rënie më të lehtë në peshën e saj në treg, duke e zbritur atë në nivelin minimal të klasifikimit.

Prania e fenomenit To Big To Fail

Duke u nisur nga perkufizimet që gjënden në literaturë sipas Labonte (2014) bankat mund të konsiderohen si TBTF duke u bazuar në madhësinë e tyre dhe gjykimin e politik-bërësve se një dështim i tyre mund të shkaktojë dëme të papranueshme të sistemit financiar. Kështu që nisur nga ky kriter duke analizuar të dhënat e disponuara mbi peshën specifike që mbajnë në sistem në rastin e Shqipërisë në kategorinë e bankave të nivelit TBTF ne mund të fusim të paktën dy bankat më të mëdha për nga peshë, që janë BKT dhe Raiffeisen Bank. Të dyja këto banka së bashku kanë një peshë mbi 45 % të totalit. Një indikator tjetër i përdorur për të klasifikuar bankat e nivelit TBTF është ai i përdorur nga Barth (2012) që peshon madhësinë e asetëve në raport me Prodhimin e Brëndshëm Bruto (PBB). Nga të dhënat e ofruara nga Banka e Shqipërisë në fund të vitit 2013 asetet e sistemit bankar në vënd ishin rreth 92% e PBB. Pra dy bankat më të mëdha në vënd i bie të kenë asetet me peshë sa 49 % e PBB.

Konkluzione dhe Rekomandime

Nisur nga analiza e bërë për nivelin e përqendrimit të sektorit bankar dhe nga vlerat e marra të indeksit HHI ne arrijmë në përfundimin se tregu bankar në vënd gëzon një konkurrueshmëri të moderuar. Duke u mbështetur në bazen teorike të Vives

(2001) i cili konkludon se për vëndet në zhvillim, siç është klasifikuar edhe vëndi ynë, niveli i moderuar i konkurrueshmërisë është i parapëlqyer pasi vëndet në zhvillim e kanë më të vështirë të ruajn stabilitetin në prani të një konkurrence të lartë, e cila siç dihet do të nxiste bankat për të marrë përsipër më shumë rrezik që perkthehet në probabilitet më të lartë për dështim.

Pra ky konkluzion i studimit tonë hedh poshtë hipotezën e ngritur që tregu bankar në Shqipëri ka nivel domethënës monopolizimi. Sidoqoftë nuk mund të themi se situata duket e qëndrueshme sidomos nëse i referohemi analizës së bërë mbi performancën e bankave të grupeve dhe respektivisht madhësisë të ndryshme. Analiza e bërë konfirmoi hipotezën e hedhur se bankat e mëdha performojnë me mirë se bankat e vogla. Nga grafikët e analizuar dukej qartë se mbijetesa e bankave të grupit të bankave të vogla ishte e rrezikuar pasi performance e tyre ishte shpesh herë negative, si rrjedhojë ndryshime të mundëshme në numrin total të bankave që operojnë në tregun vëndas apo i peshës specifike që ato mbajnë në raport me sistemin do të ndikonte në mënyrë të pashmangëshme në rritjen e indeksit të përqëndrimit të tregut HHI. Kjo gjë do të rezultonte në ulje të konkurrueshmërisë së sektorit ose thënë ndryshe në monopolizimin e tij.

Studime teorike dhe empirike përmëdin tendencën dhe synimin e bankave për t'a klasifikuar veten në kategorinë e bankave TBTF; Brewer dhe Jagtiani (2007) konkludojnë se bankat e nivelit të vogël apo të mesëm kanë stimuj për të hyrë në marrëveshje shkriresh M&A në mënyrë që të kalsifikohen si TBTF. Për të ruajtur dhe përmirësuar konkurrueshmërinë e sistemit rekomandimi ynë do të ishte që marrëveshje shkriresh që shkaktajnë rritje të indeksit HHI, sidomos në rastet kur delta e indeksit HHI mbas shkriresh kalon vlerat e 250 pikëve— kriter ky i përmëdur në legjislacionin Europian— të mos lejohen. Këtë e theksojmë për arsye se Autoriteti i Konkurrencës në vëndin tonë tashmë nuk e klasifikon përqëndrimin e tregut si faktor monopolizues.

Në përfundim të këtij studimi ne rekomandojmë ndryshime në strategjitë e zgjedhura nga bankat e vogla / të mesme. Duke patur parasysh se bankat e mëdha i lejojnë vetes kosto operative më të ulëta dhe për rrjedhojë ofrojnë shërbime më të lira/ më të mira, mënyra e vetme për të mbijetuar e bankave të vogla do të ishte specializimi sektorial ose rajonal.

Bibliografia

- Barth, R, J, Prabha, A dhe Swagel, P. (2012). *Just How Big is the Too Big To Fail Problem?*. Vol. 7, faqe: 17
- Bikker, A, J. (2009). *Sizing up Performance Measures in the Financial Services Sector*. 66.
- Bikker, A, J. dhe Bos, J.W.B. (2005), "Trends in competition and profitability in the banking industry: a basic framework", Suerf Series 2005/2.
- Bikker, A, J. dhe Bos, J.W.B. (2008), *Bank Performance: A theoretical and empirical framework for the analysis of profitability, competition and efficiency*. Routledge International Studies in Money and Banking, Routledge, Londen & Neë York, faqe: 176.
- Bikker, A, J dhe Haaf, K. (2002). *Measures of Competition and Concentration in the Banking Industry: a Review of Literature*. Vol 4, 20.
- Brewer III, E. dhe Jagtiani, J. (2007). *How Much Would Banks Be Willing to Pay to Become "Too-Big-To-Fail" and to Capture Other Benefits?*. Vol.3, faqe: 13-14.
- Claessens, S dhe Laeven, L. (2005). "Financial Dependence, Banking Sector Competition, and Economic Growth". 5.
- Deidda, L dhe Fattouh, B. (2002). "Concentration in the Banking Industry and Economic Growth". Vol.5.
- Ferreira, C. (2012). *Bank market concentration and efficiency in the European Union: a panel Granger causality approach*. 11.
- Labonte, M. (2014). *Systemically Important or "Too Big To Fail" Financial Institutions*. Vol.1, faqe: 5-7.
- Official Journal of the European Union (2004/C 31/03). *Guidelines on the assessment of horizontal mergers under the Council Regulation on the control of concentrations between undertakings*. 6-7.
- U.S Department of Justice and Federal Trade Commission (2010). *Horizontal Merger Guidelines*. 10.
- Vives, X. (2001). *Competition in the Changing World of Banking*. Oxford Review of Economic Policy, 17(4), 535-547.

Raporte dhe Publikime Periodike

- Banka e Shqipërisë (2003). *Historia e Bankës Qëndrore në Shqipëri*. 128-200.
- Banka e Shqipërisë Departamenti I Mbikqyrjes. *Mbikqyrja Bankare Raporti Vjetor 1999 - 2013* Shoqata Shqiptare e Bankave. *Raport Vjetor 2004 - 2013*


ANEKS

TABELA A1: PESHA SPECIFIKE E BANKAVE NE RAPORT ME TOTALIN E ASETETEVE TE SISTEMIT.

Grupimi		BANKAT (treguesi ne %)	Totali bilanci 2007	Totali bilanci 2008	Totali bilanci 2009	Totali bilanci 2010	Totali bilanci 2011	Totali bilanci 2012	Totali bilanci 2013
G3	1	Banka Raiffeisen	31.90	30.10	28.28	27.90	28.70	26.40	23.20
	2	Banka Kombetare Tregtare	13.40	12.30	14.40	15.60	17.70	20.50	21.90
	3	Banka Intesa SanPaolo Albania	14.30	12.90	13.00	12.10	11.30	10.70	11.00
	4	Banka Credins	4.80	4.90	5.70	7.20	7.60	7.80	8.80
	5	Banka Tirana	9.10	9.80	9.50	9.10	8.10	7.70	7.40
G2	6	Banka Alpha Albania	7.10	8.50	7.30	6.50	6.20	6.30	6.10
	7	Banka Societe Generale Albania	5.00	4.30	4.30	4.60	5.00	5.10	5.60
	8	Banka Procredit	4.00	3.70	4.70	4.20	3.60	3.40	3.30
	9	Banka NBG Albania	4.20	6.60	4.80	4.40	3.50	3.10	3.20
	10	Banka Union	1.10	1.50	1.90	2.20	2.10	2.30	2.60
	11	Banka Credit Agricole Shqiperi	2.80	3.10	3.30	3.10	2.80	2.60	2.40
G1	12	Banka Veneto	0.40	0.50	0.70	0.90	1.20	1.40	1.80
	13	Banka e Pare e Investimeve	0.30	0.40	0.70	0.80	0.80	1.10	1.40
	14	Banka Nderkombetare Tregtare	0.70	0.60	0.80	0.70	0.80	0.70	0.70
	15	Banka e Bashkuar e Shqiperise	0.70	0.60	0.50	0.50	0.60	0.50	0.50
	16	Banka e Kreditit te Shqiperise	0.30	0.20	0.20	0.20	0.20	0.10	0.10
		Totali	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00


Burimi: Tabela është ndërtuar nga autorët

GRAFIKU A.2: PERFORMANCA PER BANKAT E GRUPIT G1




Burimi: Grafiku është ndërtuar nga autorët

GRAFIKU A.3: PERFORMANCA PER BANKAT E GRUPIT G2



Burimi: Grafiku është ndërtuar nga autorët

GRAFIKU A.4: PERFORMANCA PER BANKAT E GRUPIT G3



Burimi: Grafiku është ndërtuar nga autorët

RESPEKTIMI I PARIMIT TË INTERESIT MË TË LARTË TË FËMIJËS NË LEGJISLACIONIN VENDAS DHE NDËRVENDASNË PROCESIN E BIRËSIMIT

SHKËNDI ÇILI

Universiteti Europian i Tiranës

cilishkendi@yahoo.co.uk

ABSTRAKT

Çështja e mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës është shumë e rëndësishme në teorinë dhe praktikën e çështjeve familjare. Sipas nenit 2 të Kodit të Familjes kjo konsideratë parësore e interesit më të lartë të fëmijës është kryesisht detyrë e prindërve, si edhe e organeve kompetente dhe gjykatave, të cilat në të gjitha vendimet dhe veprimtaritë e tyre duhet të kenë në qendër pikërisht këtë interes.

Neni 54 i Kushtetutës garanton të drejtën e fëmijëve të kenë një mbrojtje të vecantë nga shteti. Në këtë kuadër institucionet publike dhe private të mbrojtjes sociale, gjykatat dhe autoriteteve administrative në vendimet e tyre kanë parasysh interesin më të lartë të familjes. Parimi i interesit më të lartë të fëmijës gjen pasqyrim të plotë në Kodin e Familjes (neni 48) ku thuhet se birësimi bëhet në interes të të birësuarit dhe në Ligjin Nr. 7650, dt. 17.12.1992, "Për birësimin e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes" neni 1, thuhet se: birësimi lejohet vetëm në rast se është në interesin e lartë të të miturit dhe garanton respektimin e të drejtave të tij themelore. Përpara se të ndërmerret praktika e birësimit, duhet të realizohet në mënyrë të domosdoshme, një studim psiko-social ndaj familjes që kërkon të birësojë fëmijën. Në këtë mënyrë, ky studim bën të mundur konfirmimin ose për të mohuar aftësitë birësuese të familjes, aftësi që duhet të jenë i një vërtetimi zyrtar. Si rrjedhojë në këtë proces, është pikërisht roli KSHB (Komitetit Shqiptar të Birësimit) dhe i Gjykatës të cilët marrin një rëndësi të vecantë në vlerësimin dhe mbrojtjen e interesit të fëmijës të cilët verifikojnë këtë interes. Është e drejta e autoriteteve të refuzojnë ose të lejojnë birësimin në varësi të kushteve dhe kritereve të vendosura nga ligji.

Fjalë kyç: Birësim vëndas dhe ndërvendas, Birësues, i Birësuar, KSHB-ja (Komiteti Shqiptar i Birësimit)

1. Hyrje

Birësimi ka për qëllim të ofrojë familjen më të përshtatshme, duke i iu përgjigjur nevojave dhe interesit më të lartë, një minoreni i cili ka përjetuar situata traumatizuese, duke përfshirë paaftësinë e familjes së tij të origjinës për të treguar një kujdes të vecantë, për arsye nga më të ndryshme, për ti ofruar kushtet e domosdoshme për mirëqenien e tij. Kjo nuk është familja biologjike e fëmijës. Për këtë arsye, familja birësuese duhet të jetë e cilësuar paraprakisht si familje e kualifikuar dhe e përshtatshme për të siguruar, në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, mbrojtjen dhe respektin e një fëmije, pikërisht më këto karakteristika që gëzon fëmija. Në këtë mënyrë fëmija duhet të rritet dhe të edukohet në një mjedis familjar sikur të ishte fëmijë biologjik i birësuesit.

Me birësim, kutpojmë transferim të të drejtave dhe përgjegjësi prindërore nga prindërit biologjikë te prindërit birësues.¹ Birësimi, është një akt juridik i cili krijon midis birësuesit dhe të birësuarit, të cilët nuk janë të lidhur midis tyre në lidhje gjaku, një marrëdhënie juridike me përmbajtje betjake dhe pasurore, krejtësisht e ngjashme me marrëdhënien juridike që krijohet në bijësinë prej gjaku. Birësimi ka në thelb të tij, një akt vullnetar me anë të të cilit synohet dhënia e statusit të fëmijës (bir/bijë), pasi në rastin e fëmijëve natyrorë, ky status fitohet mbi bazën e faktit natyror të prejardhjes gjinore. Akti i birësimit synon në një njehsim të plotë të bijësisë prej gjakut dhe atij birësues. Pavarësisht se këto lidhje krijohen për shkaqe të ndryshme, këto nuk mund të pengojnë që fëmija i birësuar të gëzojë të njëjtat të drejta që gëzon edhe fëmija natyror.²

Qëllimi i birësimit është që ti sigurohet fëmijës që i është privuar ose jo mjedisi familjar mundësia të vendoset në mënyrë të përhershme në një familje birësuese. Pra, ajo cka përbën qëllimin dhe konsideratën kryesore të birësimit, është interesi më i lartë i fëmijës dhe mbrojtja e respektimit i të drejtave themelore të këtij. Në këtë proces roli i KSHB dhe i Gjykatës merr një rëndësi të vecantë në mbrojtjen e interesit të fëmijës të cilat verifikojnë e ri-verifikojnë këtë interes. Është detyrë e këtyre autoriteteve që të verifikojnë se të gjitha kushtet e domosdoshme janë të plotësuar. Është e drejtë e tyre të refuzojnë ose lejojnë birësimin në varësi të kushteve dhe kriterëve të vendosura nga ligji. Këto duhet të tregojnë një vëmendje të vecantë ndaj mbrojtjes së fëmijës nga cdo lloj përfitimi i padrejtë si edhe cdo lloj veprimtarie që synon rrëmbimin, shitjen dhe trafikimin e tyre.

Legjislacioni shqiptar e shikon birësimin si një mundësi për jetë familjare të përhershme në familjen birësuesi si për fëmijën të cilit i mungon ose është i privuar nga mjedisi familjar ashtu edhe në rastin e fëmijës jo të privuar nga ky mjedis.⁴ Kjo procedurë birësimi shoqërohet me një praktikë administrative dhe gjyqësore përmes së cilës fëmijës që i është privuar ose jo nga mungesa e mjedisit familjar, i sigurohet një jetë e re.

Kur procesi i birësimit përfundon me anë të një vendimi të gjykatës së shkallës së arë që është i përvokueshëm, (i parikthyeshëm), statusi ligjor i fëmijës kalon nga ai i prindërve biologjik, tek prindërit birësues. Në këto rrethana, të dhënat në certifikatën e lindjes së fëmijës, ndryshojnë certifikatë të re.

2. Birësimi në këndvështrimin historik

Birësimi është një institucion i lashtë juridik dhe shoqëror. Trajtesat fillestare (në kuptimin sociologjik⁵) i gjejmë qysh para lindjes së shtetit dhe së drejtës⁶. Institutit i birësimit ishte mjaft i shprehur në Romën e Lashtë, por ka qenë i njohur gjithashtu edhe në Greqi, Egjipt, Mesopotomi dhe në Babiloni. Duke marrë për bazë aspektin kohor, mund të thuhet se dy kanë qenë qëllimet kryesore të birësimit në kohën e lashtë: qëllim dominues i birësimit të fëmijëve të kushurinjëve ose të fëmijëve të proletarëve të varfër ka qenë nevoja e mbrojtjes së pasurisë së qytetarëve të pasur dhe ruajtje e vazhdimësisë së familjes, të traditës dhe të kultit të familjeve të qytetarëve pa fëmijë. Për aritjen e këtyre qëllimeve, romakët e vjetër birësuan personat meshkuj madhorë. Pikërisht kjo, tregon se birësimi i meshkujve madhorë atëherë nuk bëhej për mbrojtjen e interesave të të birësuarit, por para së gjithash për shfrytëzimin e punës së tij dhe për mbrojtjen e interesave të familjes e cila birësonte personat meshkuj madhorë.

*Adrogatiz*⁷ ishte mënyra solemne e birësimit të personave meshkuj madhorë sui juris. Me rastin e aktit të adrogimit, që kryhej para “*comita colata*”, i adroguari hiqte dorë nga familja e tij, nga kulti i tij familjar dhe kalonte si anëtar i familjes së birësuarit. Në shekullin e kaluar, ndryshe nga koha e lashtë, qëllim parësor i birësimit bëhet mbrojtja e interesave të fëmijëve

Illir Çumani. Mendimi dhe interpretimi Juridik. Birësimi, ky ligj pak i njohur nga të gjithë dhe i keqkuptuar. <http://ëëë.gazetashqip.com/sociale/20c257c32304e5c6ed7de8bdaa61dd20.html>. vizituar për herë të fundit date 17 qershor 2012

Giovani Bonilini: “Komentari I të Drejtës Familjare”, Dott. A. Giuffrè, Milano

Programi I Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës 2009 – 2012 për Gjyqtarë e Prokurorë. http://ëëë.magjistratura.edu.al/media/users/4/PTV_2009_2012.pdf, fq. 90. vizituar për herë të fundit dt 17 Qershor 2012

Sonila Omari. Instrumenta ligjore në mbrojtje të të miturit të privuar nga kujdesi prindëror. Birësimi dhe kujdesataria. Tiranë 2012. faqe 18-19

Podrovcica, Hamdi. (2012) ‘Birësimi në rregullativën e re ligjore’, e vlefshme në linkun :<http://pdfdoenloadfree.net/?pdfurl=1qeXpurpn6EihSUPOGul66nh7DhpIE8ydLU24m48rr3NfV0teHr9ufoayL1Jah6Kean6mYzejc1aqhmOXr3aPiztjY6M7VltTi2ZjR4dmk3cnSnqeb07DG3dbSzcTV2ePU3tjZxqLYdaUpOs>, vizituar për herë të fundit 14 qershor 2012.

Vojislav, Bakic. Veper e cituar, faqe 22.

Adrogatio ishte mënyra solemne e birësimit të personave meshkuj madhorë *sui juris*. Me rastin e aktit të adrogimit, që kryhej para *comita colata*, i adroguari hiqte dorë, nga familja e tij, nga kulti i tij familjar dhe kalonte si anëtar i familjes së birësuesit. Shih: Ivo Puhani: vepra e cituar, faqe 193.

të mitur në legjislacionet e shumë vendeve të botës, pra ndryshon edhe qëllimi i birësimit. Kështu pra sipas të drejtës romake marrëdhënia familjare krijohej *aut natura*, pra si rezultat i lidhjes së drejtëpërdrehtë të gjakut ndërmjet prindit e fëmijës, por edhe *aiure*, në këtë rast bazuar në një veprim juridik që njihet me termin *adoptio*.⁸Theksojmë se ndërmjet qëllimit që ndiqte *adoptio* në të drejtën romake dhe konceptit të birësimit të rregulluar nga e drejta moderne, ka një ndryshim thelbësor.⁹ Birësimi ka gjetur një rregullim juridik që në **ligjet e Hamurabit** (2283-2241 para erës sonë) dhe mori një zhvillim më të gjerë në të drejtën romake, megjithëse atëherë kishte një natyrë tjetër, sepse synonte në shtimin numerik të familjes romake.¹⁰

Në vendin tonë rregullimi juridik i birësimit u përfshi në Kodin Civil të Mbretërisë Shqipëtare, i cili hyri në fuqi më 1 prill 1929. Në të vërtetë Kodi Civil përdor termin “*adoptim*”¹¹. Në këtë Kod parashikohet parimi i interesit më të lartë të të birësuarit. Sipas tij, birësimi mund të bëhet vetëm nëse ka shkaqe të arsyeshme dhe është i dobishëm për të birësuarin. **Kodi Civil¹² i vitit 1929**, parashikon kushtet që duhet të plotësojë birësuesi për të birësuar një fëmijë. Mund të birësojë vetëm personi që në kohën e birësimit nuk kishte as fëmijë, as të paslindur legjitimë që kishin mbushur moshën 40 vjeç dhe që kishte të paktën 15 vjet diferencë me personin që do të birësohej. Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare parashikon të drejtën e të birësuarit për të mbajtur lidhjet me familjen e origjinës dhe për të gëzuar të gjitha të drejtat që rrjedhin prej saj. Ky Kod njihet të **drejtën e revokimit** të birësimit. Revokimi bëhej nga gjykata për shkaqe shumë të rënda mbi kërkimin e birësuesit ose të birësuarit.¹³

Instituti i birësimit **mori një rëndësi** mjaft të madhe pas Luftës së Dytë Botërore, si pasojë e së cilës mjaft fëmijë mbetën pa familje.¹⁴ Kjo bëri që të formohej një koncept i ri për birësimin si e vetmja mënyrë e përfitimit të marrëdhënieve prindërore ndaj fëmijëve të privuar nga prindërit e tyre biologjikë. Si rrjedhojë një rol të rëndësishëm ka luajtur Konferenca e Hagës. Përpos rolit të rëndësishëm të Konferencës së Hagës, një ndikim të madh nga ky moment ushtron mbi birësimin psikologjia edhe shkenca të tjera sociale të cilat studiuari problematikën dhe pasojat e këtij instituti.¹⁵ Si rrjedhim i këtyre studimeve u arrit në përfundim se birësimi kërkon nga ana e fëmijës një përpjekje për të rindërtuar me një jetëgjatësi marrëdhënieve të reja, për të mposhtur humbjen e prindërve të tij biologjikë për të krijuar lidhje të reja me prindërit birësues si dhe për të fituar një identitet të ri. Gjendja bëhet më e vështirë kur flitet sidomos për një fëmijë të një moshe të caktuar që ka një histori sociale dhe jo vetëm një histori gjenetike.

Me ligjin nr.61 datë 17.5.1945 “*Mbi abrogimin e dispozitave të vëna gjatë okupacionit dhe mbi vlefshërinë juridike të dispozitave ligjore të vëna para datës 7.4.1939*”,¹⁶si dhe me dekretligjin nr.392, datë 25.1.1947 “*Mbi interpretimin autentik të nenit 3 të ligjit nr. 61, datë 17.05.1945*”, dispozitat e Kodit Civil të vitit 1929 u konsideruan të shfuqizuara, por, për aq kohë sa ato nuk vinin në kundërshtim me rendin e ri, do të vlenin si rregulla juridike ndihmëse. Këto rregulla juridike ndihmëse u përdorën deri në miratimin e ligjeve të reja. Më pas rregullimi ligjor i çështjes së të miturve u bë me anë të ligjit nr.431, datë 15.05.1947 “*Mbi tutelën dhe adoptimin e fëmijëve të mitur dhe pa prindër*”. Ky ligj luajti rol të madh në mbrojtjen e fëmijëve pa prindër dhe të atyre që ishin në pamundësi për të ushtruar të drejtat e tyre prindërore.¹⁷ Format juridike me anë të të cilave realizohej kjo mbrojtje ishin *tutela*, që nënkupton vendosjen e fëmijëve nën kujdesin e personave të tjerë deri në arritjen e moshës madhore, *adoptimi*, që nënkupton krijimin e lidhjeve të njëjta si ato të fëmijëve me prindërit natyrorë dhe patronazhi, që nënkupton angazhimin e insituteve dhe të organizatave në ndihmë të insituteve të fëmijëve, me qëllim që të kontribuonin në përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës.¹⁸ Organet kompetente që do të realizonin procedurat e birësimit ishin Komisionet e Nënprefekturave për Tutelën dhe Adoptimin. Kujdes i vecantë tregohet në rastet e birësimit me qëllim që të mbroheshin interesat, e fëmijëve duke e bazuar pozitën e tyre me atë të fëmijëve natyrorë të prindërve birësues.

Birësimi u rregullua në mënyrë **më të plotë** me Ligjin nr.602, datë 19.05.1948 “*Mbi adoptimin*”, pasi me këtë ligj¹⁹ u përcaktuan më gjerë kushtet dhe mënyrat e lidhjes së birësimit, të drejtat dhe detyrat e birësuesit dhe të të birësuarit si dhe rastet e pushimit të tij (revokimi i birësimit). Për kryerjen e procedurave duhej pëlqimi i të dy prindërve biologjikë të të birësuarit ose i kujdestarit të tij, si dhe pëlqimi i të miturit kur ai kishte mbushur moshën 10 vjeç. Me birësimin nuk lindin, midis të birësuarit dhe gjinisë së birësuesit, raporte gjinie, kjo sepse ligji njihet vetëm birësimin e revokueshëm (jo të plotë).

Me dekretin nr.3327, datë 1.9.1961 **u ndryshua** neni 18 i ligjit nr.602 datë 19.5.1948 “*Mbi adoptimin*”. Sipas këtij ndryshimi,

Adoptio paraqitet në dy lloje të ndryshme: birësimi i mirfilltë, si pasojë e të cilit personi që ndodhej nën *patria potestas* të një *pater familias*, kalonte nën një tjetër *patria potestas*; dhe *adrogatione*, ku i birësuarit ishte një person *sui-iuris*-person që nuk ndodhej nën pushtetin e asnjë *pater familias*, i cili kalonte nën *patria potestas* të personit që e birësonte, duke u bërë kështu si pasojë e birësimit, një *alieni iuris*.

Në të drejtën romake marrëdhënia familjare nuk bazohej në lidhjen e gjakut, sikurëse ndodh në të drejtën modern, por bazohej në një lidhje civile që njihet me termin *agnacione*. Vetëm më vonë, në fazën e fundit të së drejtës romake, *cognatione* apo lidhja e gjakut do të shërbejë si bazë për lindjen e marrëdhënies familjare. Për sa më lart, është më se e kutpueshme se birësimi ka luajtur në të drejtën romake një rol të dorës së parë.

Ksanthipi Begeja. E Drejta Familjare e RPSSH, viti 1984, faqe 187.

Fjala “*adoptim*” vjen nga latinishtja dhe do të thotë “*të zgjedhësh*”

Kodi Civil I Republikës së Shqipërisë I vitit 1929

Neni 274 I Kodit Civil të vitit 1929.

Podrovica, Hamdi (2012) “Birësimi në rregullativën e re ligjore”, E vlefshme në linkun, <http://pdfdoenloadfree.net/?pdfurl=1qeXpurpn6EihSupOGul66nh7DhpIE8ydLU24m48rr3NfV0teHr9ufoayL1Jah6Kean6mYzejc1aqhmOXr3aPiztjY6M7Vlti2ZjR4dmk3cnSnqeb07DG3dbSzcTV2ePU3tjZxqLYydaUpOs>, vizituar për herë të fundit 14 qershor 2012.

Arta Mandro, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani. E drejta Familjare, “Kristalina KH”, Tiranë 2006, faqe 240.

Kodi Civil i vitit 1929

Ligjit nr.431, datë 15.05.1947 “*Mbi tutelën dhe adoptimin e fëmijëve të mitur dhe pa prindër*”.

Ksanthipi Begeja. E Drejta Familjare e RPSSH, viti 1984, faqe 45.

Ligjin nr.602, datë 19.05. 1948 “*Mbi adoptimin*”

birësuesit kishin mundësinë që të kërkonin të regjistroheshin si prindërit e të birësuarit, duke i dhënë atij mbiemrin, amësinë dhe atësinë e tyre, për realizimin e këtyre të drejtave duhet që birësuesit të ishin bashkëshortët (ose të ve) dhe të merrej pëlqimi i prindërve biologjikë, kujdestarit të fëmijës dhe i vetë fëmijës që do të birësohej nëse kishte mbushur moshën 14 vjec. Në këtë ligj parashikohet pushim/ revokimi i birësimit, i cili realizohet, me kërkesë të të birësuesit për shkaqe më rëndësi osekur arrihej një marrëveshje mes tyre.²⁰

Kodi i Familjes miratuar me ligjin nr. 4020, datë 20.6.1965, që hyri në fuqi në datën 1.01.1966, shënonte një tjetër hap me rëndësi në zhvillimin e institutit të birësimit. Parashikohet birësimi në interes të të miturit, duke vendosur mes birësuesit dhe të birësuarit lidhje të njëjta si ato midis fëmijëve dhe prindërve biologjikë. Në ndryshim nga legjislacioni pararendës, lejohet birësimi i një madhori me kusht që në kohën e miturisë të jetë rritur nga birësuesi. Gjithashtu, të drejtat dhe detyrimet midis të birësuarit dhe të paslindurve të tij, nga njëra anë dhe gjinisë së tij nga ana tjetër, pushojnë.²¹

Organi kompetent për përfundimin e birësimit është **gjykata**. Nevojitet pëlqimi i të dy prindërve biologjikë të të miturit që do të birësohet ose i kujdestarit të tij, i birësuesit, si dhe pëlqimi i të miturit, i cili ka mbushur moshën 10 vjec. Pëlqimi i personit që do të birësojë, i bashkëshortit të tij, iprindërve biologjike ose i kujdestarit të të miturit, si dhe i bashkëshortit të këtij, duhet të jepet përpara gjykatës. Birësimi mund të pushojë për shkaqe më rëndësi, në bazë të kërkesës së paraqitur përpara gjykatës, nga i birësuarit ose birësuesi. Kur i birësuarit është i mitur gjykatë duhet të vendosë në bazë të kërkesës së prindërve biologjikë, prokurorit ose Këshillit Kujdestarisë. **Kodi Familjes**, i miratuar me ligjin nr.6599, datë 29.6.1982, parashikon se birësimi kryhet në interes të të miturit. Interesi i të miturit është kushti themelor për realizimin e procedurave të birësimit.²²Kodi i Familjes i vitit 1982, nuk solli ndryshime të mëdha në raport me Kodin e vitit 1966.

3. Parimi i interesit më të lartë të fëmijës

Parimi i interesit më të lartë të famijës është një prej parimeve më të rëndësishme në teorinë dhe praktikën e çështjeve familjare dhe më gjerë.²³Neni 54 i Kushtetutës garanton të drejtën e fëmijëve të kenë një mbrojtje të vecantë nga shteti. Në këtë kuadër institucionet publike dhe private të mbrojtjes sociale, gjykatat dhe autoriteteve administrative në vendimet e tyre kanë parasysh interesin më të lartë të familjes.²⁴Parimi i interesit më të lartë të famijës gjën pasqyrim të plotë në Kodin e Familjes²⁵ (neni 48) ku thuhet se birësimi bëhet në interes të të birësuarit dhe në Ligjin Nr. 7650, dt.17.12.1992, “*Për birësimin e të miturve nga nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes*” neni 1, thuhet se birësimi lejohet vetëm në rast se është në interesin e lartë të të miturit dhe garanton respektimin e të drejtave të tij themelore.²⁶ Gjithashtu, në Kodin e Familjes neni 64, bëhet fjalë për marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve thuhet se e drejta prindërore ushtrohet vetëm në interes të fëmijës së mitur dhe me marrëveshje ndërmjet dy prindërve.

Të gjitha masat mbrojtëse të marra në favor të fëmijëve duhet të drejtohen në kërkimin e interesit më të mirë të tij dhe të respektimit të të drejtave themelore. ²⁷ Kjo nënkupton që:

Birësimi nuk është një marrëveshje midis subjekteve private. Është një masë ligjore e sociale për mbrojtjen e fëmijëve. Duhet parashikuar dhe autorizuar vetëm me këtë qëllim. Shtetet janë përgjegjes të kontrollojnë që kjo gjë të zbatohet.

Kjo gjë duhet parashikuar për të gjithë fëmijet të cilëve i ua kërkon situata familiare e personale, pa paragjykim për konditat sociale, të shendetit fizik dhe mendor, të racës, etnisë dhe të kulturës.

c) Fëmija duhet të jetë pikë fillimi i nisjes se procedurës së birësimit të tij. Kjo procedurë vihet në zbatim sepse e kërkon vetë situata e minorit dhe jo sepse disa persona shprehin dëshirën për ta birësuar atë ose janë në kërkim të një fëmije.

d) Zhvillimi i rastit të secilit fëmijë nuk mund ti besohet prindërve biologjike, mediatorëve jo të kualifikuar ose me një etike profesionale të diskutueshme, ose prindërve të mundshëm birësues. Ai duhet t'i besohet shërbimeve kompetente në sektorin embrojtjes së fëmijëve, mundësisht të jenë multidisiplinare, të njohura, e një supervizimi periodik nga ana e autoriteteve kombëtare kompetente.

Operatorët profesionalë që ndërhyjnë në procedurën e birësimit duhet që në konceptimin e tyre të punës dhe në praktikë të jenë të drejtuar kryesisht nga nevojat e fëmijës sepse është ai që lejon të krijohet një situatë ose raporte familjare të kënaqshme për të gjithë personat e përfshirë.

Duke marrë parasysh që koha ka një rëndësi shumë të madhe në zhvillimin e minorit, operatorët profesionalë duhet

të veprojnë sa më shpejt të jetë e mundur por jo që kjo të çojë në shkeljen e procedurave.

Me dekretin nr.3327, datë 1.9.1961 u ndryshua neni 18 i ligjit nr.602 datë 19.5.1948 “*Mbi adoptimin*”.

Kodi i Familjes miratuar me ligjin nr. 4020, datë 20.6.1965

Kodi i Familjes, i miratuar me ligjin nr.6599, datë 29.6.1982

Arta Mandro-Balili. Parimi I interesit më të lartë të fëmijës. Rëndësia dhe sfidat e zbatimit të tij. Revista Jeta Juridike 2008.<http://drejtesiashqiptare.com/?p=1028> vizituar për herë të fundit në 19 qershor 2012

Konventa mbi të drejtat e fëmijës (CRC).Raporti fillestar dhe i parë periodik i shteteve palëhttp://ëëë.mfa.gov.al/dokumenta/crc_report.pdf. vizituar për herë të fundit më 14 maj 2012

Kodi i Familjes së RPSH, neni 48

Kodi i Familjes së RPSH, neni 1

Qendra Ndërkombetare e Referimit per Mbrojtjen e Minoreneve në Birësim- Gjenevë. Shërbimi Social Ndërkombëtar / Seksioni Italian. Të drejtat e fëmijëve në birësimin Kombëtar dhe Ndërkombëtar.<http://ëëë.issssi.org/2009/assets/files/ethicaldocument/EthicalGuide/Ethical%20Guide%2099%20ALBANIAN.pdf> vizituar për herë të fundit 27 qershor 2012

Fëmija, sipas moshës dhe nivelit të pjekurisë, duhet të jetë i informuar dhe i konsultuar me të gjitha projektet e jetës që i përkasin.²⁸

4. Kuadri ligjor aktual vëndas dhe ndërvëndas dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ

Instituti i birësimit në të drejtën aktuale shqiptare rregullohet nga Kodi i Familjes, miratuar me ligjin nr.9062, datë 8.5.2003, që ka hyrë në fuqi me 21.12.2003, si dhe nga ligji Nr. 7650, datë 17.12.1992 “Për birësimin e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes”.²⁹Sipas legjilacionit shqiptar *fëmijë*³⁰ konsiderohet qenia njerëzore e lindur gjallë deri në moshën 18 vjec, moment kur ai fiton zotësi të plotë juridike për të vepruar.Me lindjen fëmija automatikisht ka zotësi juridike, e cila e shoqëron atë gjatë gjithë jetës. Përsa i përket mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve para lindjes së tyre, në Kodin Civil³¹, neni 2, parashikohet se zotësia juridike fillon me lindjen e personit gjallë dhe mbaron me vdekjen e tij. Fëmija kur lind i gjallë gëzon zotësi juridike që nga koha e zënies.

Qëllimi i birësimit³² është që ti sigurohet fëmijës që i është privuar ose jo, mjedisi familjar mundësia të vendoset në mënyrë të përhershme në një familje birësuese. Pra, ajo cka përbën qëllimin dhe konsideratën kryesore të birësimit, është interesi më i lartë i fëmijës dhe mbrojtja e respektimit të të drejtave themelore të këtij. Në këtë proces roli i KSHB dhe i Gjykatës merr një rëndësi të vecantë në mbrojtjen e interesit të fëmijës të cilat verifikojnë e ri-verifikojnë këtë interes. Është detyrë e këtyre autoriteteve që të verifikojnë se të gjitha kushtet e domosdoshme janë të plotësuar. Është e drejtë e tyre të refuzojnë ose lejojnë birësimin në varësi të kushteve dhe kriterëve të vendosura nga ligji.Këto duhet të tregojnë një vëmendje të vecantë ndaj mbrojtjes së fëmijës nga cdo lloj përfitim i padrejtë si edhe cdo lloj veprimtarie që synon rrëmbimin, shitjen dhe trafikimin e tyre.

Legjislacioni shqiptar e shikon birësimin si një mundësi për jetë familjare të përhershme në familjen birësuese si për fëmijën të cilit i mungon ose është i privuar nga mjedisi familjar ashtu edhe në rastin e fëmijës jo të privuar nga ky mjedis.³³Kjo procedurë birësimi shoqërohet me një praktikë administrative dhe gjyqësore përmes së cilës fëmijës që i është privuar ose jo nga mungesa e mjedisit familjar, i sigurohet një jetë e re. Kur procesi i birësimit përfundon me anë të një vendimi të gjykatës së shkallës së parë që është i parevokueshëm, (i parikthyeshëm), statusi ligjor i fëmijës kalon nga ai i prindërve biologjik, tek prindërit birësues. Në këto rrethana, të dhënat në certifikatën e lindjes së fëmijës, ndryshojnë certifikatë të re.

Efektet e birësimit fillojnë kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë. Karakteristika e birësimit të plotë dhe të parevokueshëm është vendosja përfundimtare e marrëdhënieve të njëjta, si ato që kanë prindërit e tyre natyror, ndërprejra në mënyrë përfundimtare e marrëdhënieve, të drejtave dhe detyrimeve, mes të birësuarit dhe familjes së tij të origjinës.³⁴Përgjegjësinë prindërore e ushtrojnë vetëm prindërit birësues. Vendimi i gjykatës, pasqyrohet në zyrën e gjendjes civile. Amësia dhe atësia e fëmijës së birësuar ndryshon si nënë dhe baba të tij të regjistruarit. E njëjta gjë ndodh edhe përsa i përket mbiemrit.

Qëllimi kryesor i birësimit ndërvëndas është t’i ofroje fëmijës një sistemim të përhershëm brënda një familje dhe kur ajo nuk bëhet e mundur në vendin e tij të origjinës, vetëm atëherë ndërhyhet nëpërmjet birësimit ndërvëndas për gjetjen e një familjeje birësuese të huaj. Duke ndjekur parimet e Konvetës së Hagës, legjislacioni shqiptar dhe K.SH.B, me zbatimin e tij garantojnë që birësimi ndërvëndas të ketë vend vetëm pasi :

është konstatuar pamundësia e gjetjes së një familjeje për të miturin në shtetin e tij të origjinës;
të jetë vendosur që birësimi ndërvëndas i përgjigjet interesit parësor të të miturit dhe se garanton respektimin e të drejtave të tij themelore, të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar dhe e drejta ndërkombëtare.

Sipas ligjit anglez, një çift i martuar mund të birësojnë, por vetëm në qoftë se të dy bashkëshortët pranojnë sëbashku.³⁵Në ndryshim nga kjo, çiftet e pamartuara nuk janë në gjendje të birësojnë bashkarisht në bazë të ligjit aktual. Megjithatë, kur zbatohet, Akti i Birësimit të Fëmijëve 2002, do të lejojë çiftet e pamartuara të birësojnë. Aktualisht një partner në një çift të pamartuar mund të birësojë, ndërsa tjetri mund të aplikojë për “mënyrë qëndrimi” (“residence order”). “Residence order” është një zgjidhje e rregullt për të bërë përsa i përket personit me të cilën një fëmijë është për të jetuar. Kjo mënyrë qëndrimi do të përfundojë kur fëmija të ketë mbushur moshën 16 vjec, ndërsa birësimi është për jetën.

Sipas ligjit Italian, një fëmijë mund të birësohet vetëm nëse ai ose ajo është shpallur “birësohet” nga gjykata e të miturit. Një fëmijë shpallet për tu birësuar në qoftë se fëmija është në një gjendje braktisjeje nga mungesa e kujdesit nga prindërit ose

Qendra Ndërkombëtare e Referimit për Mbrojtjen e Minorenëve në Birësim- Gjeneve.Shërbimi Social Ndërkombëtar/Seksioni Italian. Të drejtat e fëmijëve në birësimin Kombëtar dheNdërkombëtar. <http://ëëë.issssi.org/2009/assets/files/ethicaldocument/EthicalGuide/>

Arta Mandro, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani. E drejta Familjare, “Kristalina KH”, Tiranë 2006, faqe 643.

Konventa mbi të drejtat e fëmijës, neni 1 (CRC).Raporti fillestar dhe i parë periodik i shteteve palë. faqe 15 http://ëëë.mfa.gov.al/dokumenta/crc_report.pdf

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë

Programi i Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës 2009 – 2012 për Gjyqtarë e Prokurorë. http://ëëë.magjistratura.edu.al/media/users/4/PTV_2009_2012.pdf, fq 90, vizituar për herë të fundit dt 17 Qershor 2012

Sonila Omari. Instrumenta ligjore në mbrojtje të të miturit të privuar nga kujdesi prindëror.Birësimi dhe kujdesataria.Tiranë 2012. faqe 18-19

Arta Mandro, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani. E drejta Familjare, “Kristalina KH”, Tiranë 2006, faqe 655.

See Section 14 of the Adoption Act 1976

të afërmit.”Braktisja” kryesisht i referohet në situatat në të cilat një fëmija nuk ka mundësi për të jetuar në një familje të tij ose të saj cilët si psh fëmijët që jetojnë në institucionet sociale ose në një familje kujdestare. Gjykata deklaroi birësueshmërinë e një fëmije me anë të një gjykimi formal dhe gjithashtu mund ta revokojë atë deklaratë nëse revokimi është në interes të fëmijës. Fëmijët të cilët kanë arritur moshën 14 vjeç nuk mund të birësohen nëse ata personalisht shprehin pëlqimin e tyre për birësim. Vetëm çiftet të cilët kanë qenë të martuar për të paktën tre vjet mund të birësojnë. Çiftet e martuara të cilët kanë qenë të ndarë në çdo kohë gjatë tri viteve të para birësimit nuk mund të birësojnë. “Kjo” kërkesë stabiliteti “mund edhe të plotësohet nëse çifti vendos të vërtetojnë nëse ato kanë jetuar së bashku për një periudhë prej tre vjet përpara martesës. Megjithatë, në raste të tilla, gjykata e të miturve duhet të bëjë gjetjen e vazhdimësisë dhe stabilitetit të marrëdhënies, duke marrë për llogari të gjitha rrethanat. Në përgjithësi, personat e vetme nuk mund të birësojnë. Ka përjashtime në raste të veçanta: në qoftë se, gjatë periudhës së provës, një prej bashkëshorteve vdes, birësimi nga ana e bashkëshortit pasjetues mund të jetë ende autorizuar në qoftë se ajo është gjetur të jetë në interesin më të mirë të fëmijës.

Ekstrakti 1₃₆

Nëse nga gjykimi i vendimit të birësimit është caktuar për fëmijën mbiemri i babait dhe i nënës, a mund të mbahet mbiemri i dyfishtë edhe në Itali? Në vendet e kulturës spanjolle (si dhe në vendet e Amerikës Latine, si Kolumbia, Kili, Peru), fëmija mban një mbiemër të dyfishtë, i cili përbëhet nga mbiemri i të atit dhe mbiemri e nënës. Ndërsa sipas ligjit aktual italian rregullator, fëmija legjitim mban mbiemrin e babait.

Ekstrakti 2₃₇

“Një vendim pozitiv i cili afirmon parimin e vazhdimësisë me të drejtën e fëmijës dhe stabilitetit emocional”: me këto fjalë, Kryetari i Qendrës Kombëtare Francois Occhiogrosso Paul komentoi në gjykimin, nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e cila ka sanksionuar të drejtën e një çifti të Ravenës që ka marrë një fëmijë për birësim, që prej kujdestarisë nga viti 2004. Gjykata e Strasburgut, theksoi se “ky vendim kishte defekte në procedurën e birësimit”, ka pasur mosrespektimin e të drejtës së prindërve për të formuar një familje”, sipas Nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”. Sipas vendimit në Bashkimin Europian, autoritetet e vendit tonë do të duhet të kompesojë me një shumë të caktuar për dëmet morale dhe tarifat e avokatit.

Ekstrakti 4

Çështja e çiftit Gasy dhe Valerie Nathalie Dubois nga viti 1989, dhe PACS që nga viti 2002, birësuan një vajzë të lindur në vitin 2000 në sajë të një lindjes mjeksore asistuar praktikuar nga Nathalie, një donatorëve anonim në Belgjikë. Dy herë gjykata franceze, gjykata e Nanterre dhe Gjykata e Apelit të Versajës në vitin 2006, nuk pranoi të miratimit Valerie e një vajze të thjeshtë. Nathalie Dubois dhe Valerie Gasy janë “të zemëruar,” tha avokati Caroline Mécary, këshilltar për dy francezët duke pohuar se «vendimi i Gjykatës kishte injoruar fëmijën, dhe analiza ishte i kufizuar në një vend konformist», duke parë vetëm situata e prindërve, por jo interesi i fëmijës.

Ecuria pasbirësuese, kontakti me familjet dhe përshtatja e fëmijës me prindërit birësues

Birësimi është një proces, emocional dhe ligjor gjatë të cilit fëmijët që nuk kanë mundur të kenë një familje biologjike, 2 prindër që të kujdesen për formimin e tij që nga lindja, të mund të bëhen anëtare të përhershëm të një familjeje tjetër. Të gjithë çiftet që janë interesuar për birësimin paraprakisht duhet të kalojnë disa procedura të përcaktuara në ligj, e gjitha kjo në interes të të miturit, duke garantuar një familje të përshtatshme për nevojat e tij specifike.³⁸

Interesat e bashkëshortëve, për birësim, konsiderohen sekondare në raport me interesat dhe nevojat e fëmijës. Ky proces zgjat në kohë dhe finalizohet me futjen e fëmijës në familje, proces ky i cili nuk përfundon këtu, pasi më tej fëmija ndiqet edhe në familje nga punonjësi social i autorizuar dhe i specializuar për këtë periudhë. Ndjekja e ecurisë pasbirësuese është një proces që ka evoluar në kohë, në funksion të ndryshimit të bazës ligjore dhe ridimensionimit të vetë birësimit si proces. Trajnimet dhe bashkëpunimet me të huajt që e realizojnë këtë proces prej vitesh, ka bërë të mundur edhe një ndjekje sa më të detajuar dhe konform të gjitha normave sociale të integritit të fëmijës në familjen e re. Komiteti është krijuar në vitin 1993 duke qenë se, lindi nevoja pasi birësimet bëheshin vetëm me një vendim gjykatë dhe më pas nuk dihej asgjë për fatin e fëmijës së birësuar, ku shkonte ai dhe me cilët njerëz jetonte.

Është mëse normale që për ndjekjen e kësaj periudhe, dhe mbi të gjitha për nxjerrjen e konkluzioneve sa më të detajuar dhe në mënyrë profesionale në lidhje me përshtatjen e familjes birësuese, duhet një profesionist i mirëfilltë i fushës së punës sociale ose i psikologjisë. Shqipëria ndaj kësaj shkence është hapur në vitet e demokracisë, vetëm nga fundi i viteve '90 kanë dalë studentët e parë të diplomuar në këto lëndë.

Se la sentenza straniera di adozione ha assegnato al bambino il cognome paterno e quello materno, il doppio cognome puo essere mantenuto anche Italia? <http://ëëë.commissioneadozioni.it/it/domande-frequenti/sezione-e/e2.aspx>, vizituar për herë të fundit 18 qershor 2012

<http://ëëë.minori.it/nees/corte-strasburgo-sC%%AC-alladozione-Foster>

Shënim: Këto informacione të përpunuara janë marrë nga një studim i bërë nga KSHB-ja, faqe 64-69

Punonjësi social pranë K.SH.B.ka hyrë në strukturë vetëm në vitin 1996, kohë në të cilën filloi edhe ndjekja e ecurisë pasbirësuese për një periudhë një vjecare. Në ligj është e përcaktuar vetëm si klauzolë, periudha pasbirësuese, ndërkohë që nuk parashikohet asnjë masë për ata çiftë që me të drejtën e tyre mund të lëvizin nga vendbanimi i mëparshëm, drejt një qyteti apo një shteti tjetër.

Periudha pasbirësuese, deri në '98 është realizuar me vizita në shtëpi, ndërsa nga '98 e deri në 2006 është realizuar nëpërmjet dërgimit të një formulari me pyetje të paracaktuara të cilat prindërit duhet ti përgjigjeshin dhe në të, të bashkangjishin edhe disa foto të fëmijës. Kjo mënyrë procedimi ka filluar me fëmijën **J. Z., i birësuar në 13-02-1998, në Shëngjin të Lezhës.**

Pyetjet konsistojnë kryesisht në: *peshën e fëmijës, gjatësinë e tij, oraret e gjumit, ushqyerja, kontaktet me bashkëmoshatarët, ecurinë e tij në kopësht apo në çerdhe, mënyrën e sjelljes në familje me prindërit dhe familjen e zgjeruar.*

Në vitin 2006 duke u nisur edhe nga praktikat e huaja, marrjen e një informacioni më të detajuar për mënyrën e procedimit edhe të vetë agjensive të huaja për ndjekjen e fëmijëve pasbirësimit, u pa e nevojshme ndjekja e kësaj periudhe në ambientin ku jeton fëmija.

Në 2007 erdhi edhe ndryshimi i ligjit të birësimit **nr.9695 date 19/03/2007**, i cili e përcaktonte periudhën pasbirësuese nga një vit në dy vjet, cdo gjashtë muaj. Gjithsesi kjo ndjekje bëhet në sajë të një marrëveshjeje të nënshkruar në mirëbesim me ata çiftë që birësojnë, pas marrjes së vendimit për birësim nga bordi drejtues i Komitetit Shqiptar të Birësimit, duke qenë se edhe në ligj nuk kanë asgjë të përcaktuar për mënyrën e procedimit ose për ndonjë penalizim të mundshëm në rast se çiftet nuk janë korrekt në atë periudhë që është mbushur edhe afati për realizimin e raportit për përshtatjen e fëmijës.

Ajo ç'ka është vënë re gjatë ndjekjes së ecurisë pasbirësuese është se, atashimi me prindërit ndryshon në varësi të moshës së tyre. Më të lehtë e kanë fëmijët e moshës 1-2 vjec, të cilët janë akoma në periudhën e foshnjërisë. Për fëmijët e kësaj moshe mund të themi se prindërit e tyre i'a arrijnë më shpejt të bëhen pika e parë e referimit për fëmijët, në lidhje me mjedisin e ri familjar-shoqëror-social. Për të gjithë ne është e rëndësishme ti japim jetë shprehjes: **Familja është shkolla e detyrave themeluar mbi dashurinë**

Statistika përmbledhëse për birësimin vendas dhe ndërvendas

Tabela 1

STATISTIKE PERMBLEDHESE³⁹ 1994 – 2011

VITI	Kerkesa Per biresim vendas	Kerkesa per biresim me pelqim	Kerkesa per biresim nder-vendas	Biresime me pelqim	Biresime vendase nga institucioni	Biresime nder-vendase	Femije te braktisur te rregjistruar	Femije te semure e te rritur te biresuar
1994	50	23	-	1	10	-	73	-
1995	36	32	11	24	27	11	90	3
1996	45	34	42	34	48	37	123	6
1997	54	27	40	15	48	39	67	4
1998	63	28	54	21	43	30	96	12
1999	57	24	58	36	41	60	60	36
2000	47	31	35	26	38	35	76	16
2001	51	30	39	31	41	47	76	29
2002	31	20	36	28	21	26	37	19
2003	46	23	31	28	28	26	62	15
2004	32	18	27	15	28	26	52	17
2005	53	25	53	24	29	37	48	27
2006	40	9	35	14	17	25	46	12
2007	31	17	40	19	29	28	72	22
2008	33	17	44	22	16	23	38	15
2009	21	19	24	19	18	15	32	8
2010	19	4	10	3	27	12	40	5
2011	22	12	7	10	19	7	40	4

Interpretimi në mënyrë përmbledhëse të statistikave të mësimpërme ⁴⁰ (1994 – 2011)

Gjatë vitit **2009** janë realizuar 18 birësime vendase ku mosha mesatare e nënës rezulton të ketë qenë 43.2 vjeç, ndërsa e babait birësues 46.7 vjeç.

Gjatë vitit **2010** janë realizuar 27 birësime ku mosha mesatare e nënës birësuese rezulton të ketë qenë 44.8 vjeç, ndërsa mosha e babait 45.3 vjeç.

Gjatë vitit **2011** janë realizuar gjithsej 19 birësime ku mosha mesatare e nënës është 41.1 vjeç, ndërsa ajo e babait 46.5 vjeç.

Shënim: Statistikat përmbledhëse janë marrë pranë Komitetit Shqiptar të Birësimit 1994-2011

Shënim: Statistikat përmbledhëse janë marrë pranë Komitetit Shqiptar të Birësimit 1994-2011

Vihet re se në këto tre vite është përafërsisht e njëjtë si moshja e nënës ashtu edhe ajo e babait. Shkaqet e kësaj përafërsie shpjegohen me faktin se çiftet e paraqitura në KSHP, kanë konsumuar vite martese së bashku dhe gjatë kësaj periudhe kanë tentuar nëpërmjet metodave mjekësore bashkekohore, derisa për ta në të shumtën e rasteve **birësimi** mbetet alternative e fundit.

Duke iu referuar numrit të kërkesave të paraqitura, vihet re një rënie e tyre nga viti në vit që mund të shpjegohet me faktin se aplikantët të cilët paraqesin kërkesën e tyre janë paraprakisht të informuar me procedurën apo me kërkesat e legjislacionit në fuqi (ligjin nr. 9695, dt. 19. 03. 2007) nëpërmjet publikimit në faqen e internetit, apo interesimit në zyrat e Komitetit. Në vitin 2011 ka një rritje të numrit të kërkesave si dhe dosjeve të rregjistruara, pasi në këtë periudhë janë përfshirë edhe pjesa e aplikantëve të cilët prisnin ndryshimet në ligjin e birësimeve.

Nga kërkesat e paraqitura në vite në krahasim me dosjet e rregjistruara rezultojnë që mesatarisht 35 % e aplikantëve fillojnë procedurat e birësimit. Rënia e numrit të kërkesave nga fshati në krahasim me kërkesat e ardhura nga qyteti shpjegohet me faktin se për fshatin mbetet pengesë plotësimi i dokumentacionit të shtëpisë si dhe tendenca për realizim birësimi me pëlqim.

Nisur nga kjo tabelë vihet re se Komiteti Shqiptar i Birësimeve, duke u nisur nga interesi më i lartë i fëmijëve, përveç elementëve të tjerë, realizon një përshtatje të studjuar ndërmjet moshës së fëmijës së propozuar dhe aplikantit birësues. Konkretisht, fëmijët me grup – moshën më të vogël janë birësuar nga prindër me moshë më të re. Me rritjen e moshës së fëmijës edhe moshja mesatare e prindërve birësues është më e madhe.

Duke krahasuar të dhënat e vitit 2009 me ato të 2010, vihet re se në vitin 2010 për të njëjtat grup – moshash të fëmijëve kemi çifte me një moshë mesatare relativisht më të re. Pra, duket qartë se moshja mesatare e prindërve birësues ka ardhur duke u ulur.

Për vitet 2009 e 2010 nuk ka patur asnjë rast birësimi të aplikantëve me moshë të madhe mbi 60 vjeç.

Përfundime dhe propozime

Instituti i birësimit konsiderohet një akt juridik solemn, me anë të të cilit synohet të vendosen, mes birësuesit dhe të birësuarit, marrëdhënie të njëjta si ato të gjinisë. Prioritet kryesor i duhet dhënë për ti lejuar fëmijës të rritet në gjirin e familjes së tij.

Birësueshmëria nuk është vetëm një situatë juridike. Ajo duhet të marrë parasysh disa elemente, si psikologjike, sociale, mjeksore dhe juridike.

Qëllimi i birësimit është që ti sigurohet fëmijës që i është privuar ose jo mjedisi familjar mundësia të vendoset në mënyrë të përhershme në një familje birësuese. Prioritet i duhet dhënë fëmijës për të lejuar që të rritet në gjirin e familjes së birësuese.

Qeveria dhe shoqëritë civile duhet të tregojnë një përkushtim të veçantë për familjet e origjinës për t'ju krijuar në këtë mënyrë mundësitë që të kujdesen për fëmijët e tyre.

Formulim i politikave dhe i programeve të cilat kujdesen për zhvillimin njerëzor dhe drejtësinë sociale, duke i ofruar familjeve dhe nënave në vështirësi mbështetje psikologjike, sociale dhe financiare.

Birësimi ndërkombëtar është ndihmës për birësimin kombëtar. Vendimi për një birësim ndërkombëtar duhet marrë vetëm pasi më parë të jetë kërkuar, pas asnjë rezultat, apo një zgjidhje e kënaqshme në vendin e tij të origjinës.

Birësueshmëri e fëmijës duhet të vendoset përpara se të ndërmerret procesi i birësimit. Pra ky vendim nuk do të vihet në zbatim pa u nisur nga një studim psiko-mjeko-social të fëmijës dhe familjes së tij të origjinës. Familja birësuese duhet të cilësohet paraprakisht e njohur si e kualifikuar., përpara se të ndërmerret praktika e birësimit.

Akresi në dokumentat e tyre do të jetë i mirë përcaktuar. Fëmija, prindërit biologjikë dhe familja birësuese gëzojnë të drejtën e konfidencialitetit dhe të respektimit të jetës së tyre.

Urdhëri i birësimit jepet nga organet kompetete për realizimin e procedurës së birësimit. Gjykata dhe KSHP-ja duhet të jenë të paanshëm në dhënie të verdiktit përfundimtar, për garantuar në këtë mënyrë interesin më të lartë të fëmijës.

Mungesa e një kufiri të përcaktuar moshe për birësuesin has probleme në zbatimin e drejtë të ligjit. Për këtë arsye, është e domosdoshme përcaktimi i moshës së prindit birësues.

Organi kompetent për përfundimin e procedurës së birësimit është gjykata. Vendimi i gjykatës, me anë të të cilit pranohet kërkesa për birësim, vendos birësimin e plotë dhe të përvokueshëm. Kjo nënkupton se fëmija i jep fund të gjitha raporteve formale dhe substanciale me familjen e origjinës.

Si legjislacioni vendas ashtu edhe ai ndërvendas barazojnë statusin e fëmijës biologjik me atë të fëmijës së birësuar.

Legjislacioni shqiptar i birësimit nuk e njeh birësimin jo të plotë, sipas të cilit fëmija i birësuar i mban lidhjet me familjen biologjike. Pra pas birësimit, i birësuarit shkëput çdo marrëdhënie juridike me familjen juridike.

Familja është dhe do mbetet ambjenti **IDEAL** për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës!!!

Bibliografia

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
Kodi Familjes së Republikës së Shqipërisë
Kodi Procedurës Civile së Republikës së Shqipërisë

Shkëndi Çili

Mandro. A, Meçaj. V, Zaka. T, Fullani.A, E drejta Familjare, “Kristalina KH”, Tiranë 2006

Omari. S. Instrumentat ligjore në mbrojtje të të miturit të privuar nga kujdesi prindëror. Birësimi dhe kujdestaria. Tiranë, 2011
Qendra Ndërkombetare e Referimit për Mbrojtjen e Minoreneve në Birësim- Gjenevë.Shërbimi Social Ndërkombëtar / Seksioni Italian.Të drejtat e fëmijëve në birësimin Kombëtar dhe Ndërkombëtar.

Ligjin nr. 8624 datë 15/06/2000 mbi Aderimin e Shqipërisë në Konventën e Hagës “ *Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit*”, (botuar në fletoren zyrtare nr.18, Korrik 2000 faqe 872).

Konventën e Kombeve të Bashkuara të 20 Nëntorit 1989 “ *Për të drejtat e fëmijëve*”, e cila ka hyrë në fuqi më 28/03/1992.

Ligjin nr. 9062 datë 08/05/2003, “*Kodi i Familjes*” (botuar në fletoren zyrtare nr.49, Qershor 2003 faqe 1907 dhe ka hyrë në fuqi më 21/12/2003).

Ligji nr 9695 date 19/03/2007 “ *Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit*” (botuar në fletoren zyrtare nr. 36 Prill 2007, faqe 960).

Ligjin Nr.10 358, datë 16.12.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9695, datë 19.3.2007 “*Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve*”.

Ligjin Nr.9443 datë 16.11.2005 “ *Për aderimin e RSH në Konventën për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prinderore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve*”.

Ligjin Nr.9359 datë 24.05.2005 “*Për raftifikimin e Konventës Europiane për mardhëniet me fëmijët*”.

Ligjin Nr.9446 datë 24.11.2005 “ *Për aderimin e RSH në Konventën për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës*”

Ligjin Nr.9544 datë 29.05.2006 ‘*Për ratifikimin e marrëveshjes mes Këshillit të Ministrave të RSH Qeverisë së Republikës Greke për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve viktime të trafikimit*”

Ligji Nr.9669 datë 18.12.2006 “ *Për masat ndaj dhunës në mardhëniet familjare*”

VKM Nr.399 datë 01.06.2011 “ *Për përbërjen dhe rregullat e funksionimit të komisionit të Miratimit të Agjensive Ndërmjetësuese të Huaja*”.

Ligji Nr 8624, datë 15.06.2000, Për aderimin në” Konventën e Hagës”, “*Për mbrojtjen e Fëmijëve dhe bashkëpunimin për Birësimet jashtë vëndit*”.

Vendim nr 4808, datë 14.05.2012 Gjykata e Shkallës së Parë

Vendimi nr 10554, datë 21.05.2012 Gjykata e Shkallës Së Parë

Vendimi nr 2425, datë 15.03.2012 Gjykata e Shkallës së Parë

Burime të marra pranë KSHB-së

Website

Overview of Italian Adoption Law. <http://ëëë.adoptionpolicy.org/pdf/eu-england.pdf>. vizituar për herë të fundit 15 qershor 2012

Overview of English Adoption Law. <http://ëëë.adoptionpolicy.org/pdf/eu-england.pdf>. vizituar për herë të fundit 15 qershor 2012

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË SHQIPËRI

PHD.CAND.ENIS URUÇI

Universiteti Aleksander Moisiu, Durrës, Shqipëri.

Lektor. Fakulteti i Studimeve Profesionale, Departamenti I Mjekesise

Doktorant pranë Universitetit Europian të Tiranës

Profili. Menaxhim Biznesi.

Adrese emaili. enisuruci@gmail.com, enisuruci@yahoo.com

ABSTRAKT

Investimet e Huaja Direkte janë një fenomen relativisht i ri, i cili ka patur një zhvillim të hovshëm në rritje në vitet në vazhdim. Nxitur nga ndryshimi teknologjik, konkurrenca globale dhe liberalizimi i tregjeve, investimet e huaja direkte luajnë një rol kyç në procesin e integritit global ekonomik. Ato krijojnë efekte si në vendet pritëse ashtu dhe në ato investuese. Efektet në vendet pritëse janë të rëndësishme si për nga shumëllojshmëria e tyre ashtu dhe për nga rëndësia ekonomike, politike dhe sociale që ato gjenerojnë. Përfitimi i këtyre efekteve nuk vjen automatikisht por ndikohet nga realizimi i disa kushteve specifike. IHD-të sjellin kapitalin e nevojshëm, rritin produktivitetin e ekonomisë nëpërmjet transferimit të njohurive dhe teknologjisë, ndikojnë në hapjen e tregjeve të reja për tregti, rritin konkurrueshmërinë e ekonomisë, ndikojnë në reduktimin e deficitit të llogarive korente, rritin punësimin dhe mbi të gjitha ndikojnë në mirëqenien e popullsisë. Rritja e investimeve të huaja është objektiv kyç për zhvillimin ekonomik të një vendi dhe prioritet strategjik i qeverive. Përthithja e këtyre investimeve kërkon politika dhe strategji të mirëpërcaktuara, përmirësime të vazhdueshme në kuadrin ligjor dhe institucional, stabilitet dhe rritje ekonomike të qëndrueshme, përmirësim dhe modernizim të infrastrukturës si dhe përmirësime në klimën për mjedisin e biznesit dhe investimeve. Investimet e Huaja Direkte janë një fenomen relativisht i ri, i cili është i dukshëm që në shekullin e XIX në formën e kreditimit që ekonomia angleze bën për të financuar zhvillimin ekonomik në vendet të ndryshme si dhe në formën e pronësisë mbi aktivet financiare. Në periudhën midis dy luftrave në shekullin e XX investimet e huaja patën një rënie të konsiderueshme.

Fjalë kyç: *IHD, Investime të Huaja Direkte, Investimet e Huaja në Shqipëri, përcaktuesit e IHD, avantazhet e IHD, zhvillimi institucional, integriti global ekonomik.*

1. Hyrje

Në periudhën midis dy luftave në shekullin e XX investimet e huaja patën një rënie të konsiderueshme. Mbarimi i luftës së Dytë Botërore shënoi dhe lulëzimin e fenomenit të IHD-ve për dy arsye themelore. Së pari, zhvillimi i teknologjisë favorizoi transportin dhe komunikacionin gjë që krijoi mundësinë e kontrollit në distancë si kusht për zhvillimin e IHD-ve. Së dyti, vendet e Evropës dhe Japonia kishin nevojë për kapitalin e SHBA për rikonstruksion. Në këtë periudhë SHBA miratoi një sistem taksimi që favorizoi investimet jashtë. Nxitur nga ndryshimi teknologjik, konkurrenca globale dhe liberalizimi i tregjeve, investimet e huaja direkte luajnë një rol kyç në procesin e integritit global ekonomik. Ato konsiderohen si një faktor përcaktues i rritjes (zhvillimit) ekonomike, vecanërisht për vendet në zhvillim, ku bën pjesë dhe Shqipëria. Rëndësia e studimit të IHD-ve dhe e të dhënave mbi ecurinë e tyre në mbarë botën qëndron në faktin që të mund të sigurohen informacione ndërkombëtarisht të krahasueshme mbi shkallën e integritit ekonomik dhe të konkurrencës së tregjeve, ndjekjen e tendencave të investimeve, me qëllim hartimin e politikave të mirinformuara për përfaqshjen ndaj këtyre investimeve.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij studimi është të tregojë në aspektin teorik lidhjen e IHD me rritjen ekonomike të një vendi, përfaqshjen e Shqipërisë ndaj IHD -vë, parë kjo në aspektin ekonomik, ligjor e social, të shpjegojë faktorët e ndryshëm që përcaktojnë “sjelljen” e IHD-vë si dhe efektet pozitive dhe negative të tyre për Shqipërinë. Studimi është menduar që ti japë përgjigje disa pyetjeve studimore, sic janë: cilat janë efektet e IHD në ekonominë shqiptare?, si ndikon klima e biznesit në vend në përthithjen e IHD?, etj. Objektivat e këtij studimi kanë të bëjnë me analizën e IHD-ve si një faktor i rëndësishëm për vendet në zhvillim në kushtet e globalitetit si dhe impakti direkt apo indirekt që ato kanë në ekonominë shqiptare, si një ekonomi në zhvillim, të analizojë rolin e përcaktuesve të investimeve të huaja direkte, duke përfshirë studimin e lidhjes ndërmjet klimës së investimeve dhe IHD-ve, dhe analizën e impaktit të IHD-ve në ekonominë e vendit si nga pikëpamja makroekonomike (rritja ekonomike dhe mbarëvajtja e tregtisë) ashtu edhe nga ajo mikroekonomike (ristrukturimi dhe ecuria e ndërmarrjes), të tregojë rolin e qeverive në vendet pritëse, rëndësinë e stabilitetit ekonomik të këtyre vendeve. Studimi është strukturuar në kapituj. Fillimisht jepet një prezantim i Investimeve të Huaja Direkte në aspektin teorik. Niset me përkufizimet e ndryshme që i bëhen IHD-ve, jepet një klasifikim i IHD-vë sipas vecorive dhe vazhdohet me listimin e faktorëve që i përcaktojnë. Kapitulli tjetër bën një paraqitje të IHD-ve në kontekstin shqiptar, politikat e ndjekura për investimet e huaja, fushat konkrete ku janë ndërmarrë. Vazhdohet me karakteristikat dhe vecoritë e ambjentit shqiptar, avantazhet dhe disavantazhet e IHD-ve në përgjithësi dhe më konkretisht në Shqipëri. Në këtë aspekt studiohet dhe analizohet fakti: pse të investohet në Shqipëri për të bërë biznes, duke listuar lehtësirat dhe pengesat që shfaq vendi ynë, hapat që janë bërë dhe masat që janë marrë për stimulimin e përthithjes së Investimeve të Huaja, politikat që kopje - 6 po aplikohen në këtë drejtim si dhe nismat e ndryshme të ndërmarrja nga qeveria. Në kapitullin e mëpasshëm, bëhet një analizë krahasimore e Shqipërisë me vende të tjera të rajonit në përfaqshjen ndaj IHD-ve, duke e krahasuar më vendet e grupit të Evropës Juglindore (EJL6), si vende me tipare relativisht të afërta me ne. Kapitulli i fundit, është një analizë e ndikimit të IHD-ve në ekonominë shqiptare. Fillimisht, nëpërmjet një vështrimi të përgjithshëm bëhet një paraqitje e ecurisë së IHD-ve në tërësi. Më pas jepet shpërndarja e tyre sipas vecorive të stokut, sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë dhe analizohen karakteristikat e secilit sektor, efektet pozitive dhe negative që kanë sjellë këto investime në secilin prej tyre, risitë që ato sollën, problematikat që shfaqën, si dhe efektet e drejtëpërdrejta apo të tërthorta që vihen re. Së fundi, renditen konkluzionet dhe rekomandimet që dalin si rrjedhim i kësaj analize.

Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Qëndrimi i përgjithshëm i mbajtur në këtë material për të adresuar objektivat e tij kryesorë, është i orientuar më shumë nga një kërkim cilësor. Kërkimi fillon me vëzhgime mbi fenomenin e IHD-së, bazuar në kërkime e materiale ekzistuese, dhe vijon më shpjegimin e modelit të sjelljes së tij. Gjithsesi, përgjatë tij, ky studim përfshin edhe elementë kërkimi sasiorë, si analiza e të dhënave statistikore dhe përpjekje për të shpjeguar ecuritë e për të dhënë strategji të mundshme. Për të përmbushur objektivat, është ndërmarrë rishikimi i një literature të gjërë që fokusohet në shpjegimin e IHD-ve dhe karakteristikave kryesore të tyre. Ndërkohë, të dhënat dytësore të mbledhura kanë ndihmuar për të njohur e kuptuar çështjet kryesore dhe elementët-kyç të lidhur me IHD. Burime të të dhënave dytësore përfshijnë: studime të mëparshme e raste studimi në këtë fushë, artikuj gazetash, raporte, tabela statistikore, baza të dhënash në internet etj.. Të dhënat mbi flukset dhe stoqet e IHD-së janë marrë nga botime të ndryshme të Librit Vjetor të Statistikave të Investimit Ndërkombëtar të OECD-së dhe materiale e raporte të botuara nga Banka Botërore. Ndarja sipas vendeve të origjinës e sipas industrisë së investimeve, shpesh është bazuar në burimë të ndryshme e mund të këtë një stok të ndryshëm IHD-je për bazë. Kryesisht është shfrytëzuar materiali i marrë nga Raporti i Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri 2010 dhe 2011. Të dhënat për PBB, PBB për frymë, popullsinë e zhvillimin ekonomik, janë marrë nga baza e të dhënave statistikore e UNCTAD. Të dhënat lidhur me Shqipërinë janë marrë nga institucione shqiptare si: Agjencia Shqiptare për Zhvillimin Ekonomik,

Banka e Shqipërisë, Ministria e Ekonomisë dhe Instituti i Statistikave (INSTAT). Përgjithësisht është punuar për të gjetur informacionin më të përditësuar të mundshëm, dhe të dhënat e disponueshme datojnë deri në vitin 2013.

Analizë, interpretim të dhënash

Në botën e sotme të globalizuar, rritja ekonomike dhe hapja e vendeve të reja të punës në ekonomitë në zhvillim dhe në tranzicion, varen nga dy faktorë kryesorë: nga Investimet e Huaja Direkte dhe nga zhvillimi i Ndërmarrjeve të Vogla të Mesme (NVM). IHD është burimi kryesor i financimeve të jashtme në vendet në zhvillim. Investimet e huaja direkte mund të rrisin formacionin e kapitalit fiks dhe ndihmojnë kopje - 17 - në bilancin e pagesave. Në pikëpamjen e UNCTAD-it, IHD ka potencialin për të gjeneruar punësim, rritje të prodhueshmërisë, aftësi transferuese dhe teknologji të re, rritjen e eksporteve, si dhe kontribuon në zhvillimin afatgjatë ekonomik të vendeve në zhvillim. Sipas të dhenave të UNCTAD-it, filialet e huaja të 64 000 korporatave ndërkombetare gjenerojnë 53 milion vende pune.

Konkluzione/ Rekomandime

Nxitur nga ndryshimi teknologjik, konkurrenca globale dhe liberalizimi i tregjeve, investimet e huaja direkte luajnë një rol kyç në procesin e integritit global ekonomik. Ato konsiderohen si një faktor përcaktues i rritjes ekonomike, veçanërisht për vendet në zhvillim, fazë në të cilën gjendet edhe Shqipëria. IHD është burimi kryesor i financimeve të jashtme në vendet në zhvillim dhe në këtë kuadër edhe i Shqipërisë. Investimet e huaja mund të rrisin formacionin e kapitalit fiks dhe ndihmojnë në bilancin e pagesave. IHD ka potencialin për të gjeneruar punësim, rritje të prodhueshmërisë, aftësi transferuese dhe teknologji të re, rritjen e eksporteve, si dhe kontribuon në zhvillimin afatgjatë ekonomik të vendeve në zhvillim. Investimet e Huaja duke patur efekt të drejtëpërdrejtë në fuqinë punetore vendase (duke shtuar më shumë mundësi punësimi dhe pagesa më të larta); mbi konsumatorët në formën e çmimeve më të ulëta dhe mbi qeverinë nëpërmjet të ardhurave më të larta nga taksat, duhet të jenë në qendër të vëmendjes nga kjo e fundit për hartimin dhe zbatimin e politikave që stimulojnë tërheqjen e investitorëve. Për të rritur stokun e IHD, Shqipëria ka nevojë për përmirësime në kuadrin ligjor dhe institucional. Aktualisht baza ligjore dhe sistemi i taksave është përafër shumë me atë të BE. Problematika qëndron në implementimin dhe funksionimin e tij, me qëllim përmirësimi në klimën për mjedisin e biznesit dhe investimeve si dhe rritjen e besimit të investitorëve. Ndër vite në Shqipëri ka patur problem pronësie për shkak të disa palëve që pretendonin pronësi për të njëjtin truall. Kjo është pranuar si një pengesë për investimet e huaja direkte. Zgjidhja e ofruar është hartimi i një projekt-ligj të ri që mbron dhe garanton investimet e investitorëve të huaj. Analizimi i avantazheve dhe disavantazheve është themelor për ndërtimin e një strategjie pozicionimi në tregun global. Pozicioni i tanishëm i Shqipërisë, është ai i një ekonomie me kosto të ulët dhe diferencim të dobët. Duke pasur avantazhin e koston së ulët, Shqipëria ka të gjitha mundësitë të lëvizë drejt një “strategjie diferencimi”. Për të implementuar këtë strategji, nevojiten mjetet e duhura dhe politikave e nevojshme. Këto mjete mund të jenë IHD-të, e zgjedhura me kujdes dhe të fokusuar në industri specifike, me qëllim krijimin e “clusters” dhe prezantimin e njohurive dhe teknologjive të reja si edhe hartimi i politikave për zhvillimin e kapitalit njerëzor. kopje - 50 - Investimet e Huaja “cënojnë” në një farë mase pavarësinë e vendit pritisht veçanërisht kur burimi i investimit vjen nga i njëjti vend. Prandaj duhet patur kujdes që raporti “kapital i huaj/kapital vendas” të mos jetë shumë i madh me qëllim që të mos krijohet varësi nga investimi i huaj. Zhvillimi i infrastrukturës është një tjetër faktor i rëndësishëm për rritjen e mëtejshme të IHD-ve, ndaj dhe përmirësimet e kohëve të fundit në rrugë dhe furnizimin me energji elektrike shënojnë një hap pozitiv në këtë aspekt. Por infrastruktura lokale ka ende mangësi dhe rrjedhimisht duhet që parqet industriale të bëhen funksionale për të garantuar shërbime me standarde të larta për investitorët e ardhshëm. Shpërndarja e ndërmarrjeve të investimeve të huaja në Shqipëri sipas sektorëve të ekonomisë nuk është uniforme. Edhe pse Shqipëria po kalon në një proces ri-industrializimi bazuar tek investimet e huaja, përfshirja e tyre në aktivitete të teknologjive më të larta është ende në nivele të ulëta. Shtrirja e investimeve të huaja. Zhvillimi i burimeve njerëzore, drejtimi dhe profesionalizimi i tyre në sektorë që ende ofrojnë mundësi për përthithjen e investimeve të huaja është një sfidë me të cilën duhet të përballet Shqipëria.

Bibliografia

- FDI, Theory, evidence and practise-Imaad A. Mossa 2002
 Dunning, John H. (2000-4). “The eclectic paradigm as an envelope for economic and business theories of MNE activity”.
 Retrieved 2011-10-12.
 UNCTAD UNDP Albania- Raporti i Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri 2010
 UNCTAD UNDP Albania- Raporti i Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri 2011
 OECD (2010). “South East Europe - Investment Reform Index 2010: Monitoring Policies and Institutions for Direct Investment”,
 Paris: OECD
 UNCTAD (WIR10). World Investment Report 2010: New York and Geneva: United Nations.
 Banka Botërore, IFC, Të bësh biznes, 2011: Të sjellësh ndryshimin për sipërmarrjet, botim i përbashkët i Palgrave MacMillan, IFC “Transformimi i

Enis Uruçi

dhe Bankës Botërore (Uashington D.C.: Bank
Stjepan Tanic- Eastern Europe and Central Asia Agroindustry Development Country brief, ALBANIA FAO Regional Office for
Europe and Central Asia
Banka e Shqiperise-Analizë e zhvillimeve në sektorin e jashtëm të ekonomisë-2012, O. Mitre, M.Boka, Departamenti i Politikës
Monetare, Prill 2013

Burime nga interneti:

AIDA/ Agjencia Shqiptare e Zhvillimit te Investimeve www.aida.com

Xhaferaj E. (2005), “Investimi i Huaj Direkt në vendet në zhvillim të Evropës Lindore: Rasti i Shqipërisë”, [http:// www. bankofalbania.org/
web/Investimi_i_huaj_direkt_ne_vendet_ne_zhvillim_te_Evropes_Lindore_Rast_3127_1.php?kc=0,22,11,7,0](http://www.bankofalbania.org/web/Investimi_i_huaj_direkt_ne_vendet_ne_zhvillim_te_Evropes_Lindore_Rast_3127_1.php?kc=0,22,11,7,0)

QKL - <http://www.qkl.gov.al/History.aspx>

KURUMI <http://www.kurumdemir.com.tr/al/kurumdemir.htm>

VËSHTRIME KRAHASUESE TË RREGULLORESSËKËSHILLITEUROPIAN “MBI JURIDIKSIONIN, NJOHJEN DHE EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE NË FUSHËN CIVILE DHE TREGTARE”

ANDJA LEVANAKU

Shkolla Doktorale

ABSTRAKT

Aktet e Bashkimit Europian që rregullojnë juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare janë:

Konventa e Brukselit nr.41968A0927 (01) “Mbi juridiksionin dhe Ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”, e datës 27 Shtator 1968.

Konventa e Luganos nr. 4198A0592 e 16 Shtatorit 1998 “Mbi juridiksionin dhe Ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”.

Rregullorja e Këshillit të Komunitetit Europian nr. 44\2001 e 22 Dhjetorit 2000. “Mbi juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”.

Të tre këto akte të Bashkimit Europian, të listuara në mënyrë kronologjike nga data e miratimit të tyre, rregullojnë të njëjtën fushë, atë të juridiksionit dhe ekzekutimit të vendimeve në fushën civile dhe tregtare.

Rregullorja e Këshillit Europian nr 44\2001 e 22 Dhjetorit 2000, vlen të vlerësohet si instrumenti më i rëndësishëm për përafrimin e legjislacionit shqiptar në këtë fushë, kjo sepse ka fuqi detyruese për vendet e Bashkimit Europian dhe shtjellon në mënyrë më të detajuar fushën e veprimit të dy Konventave të mësipërme duke rregulluar njohjen e vendimeve. Lënda që rregullohet nga Konventa e Brukselit, u normua nëpërmjet Rregullores. Kjo rregullore zbatohet drejtpërdrejt në vendet e Bashkimit Europian dhe ka zëvendësuar në një masë të madhe Konventën e Brukselit të vitit 1968. Fusha e zbatimit të rregullores është përcaktimi i Juridiksionit të shteteve anëtare të Bashkimit Europian, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve në fushën civile dhe tregtare. Njohja e kësaj rregulloreje është shumë e rëndësishme duke patur parasysh prespektivën e Shqipërisë për integrim në Bashkimin Europian.

Fjalë kyç: *Juridiksioni, Rregullore e Këshillit Europian, Derogimi i juridiksionit, Pezullimi i gjykit, sigurimi i padisë*

Hyrje

Juridiksioni gjyqësor shtrihet në disa fusha, pra shfaqet në disa lloje si, siç është juridiksioni civil, juridiksioni penal, juridiksioni në fushën e marrdhënieve tregtare etj.

Në këtë temë do të analizoj Rregulloren e Këshillit Europian nr 44/2001 e 22 Dhjetorit 2000 “ Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare ” dhe ndryshimet që ka kjo rregullore me Kodin e Procedurës Civile Shqiptare. Për njohje dhe aplikim më të mirë të akteve ligjore ndërkombëtare në fushën civile dhe tregtare.

Megjithëse kjo rregullore nuk ka efekt detyrues për Shqipërinë, njohja e saj na shërben për të vënë në dukje ndryshimet thelbësore që ka me legjislacionin shqiptar, për njohje më të thellë ndaj akteve të Bashkimit Europian në këtë fushë dhe përmirësimin e legjislacionit duke u përafuar me aktet ndërkombëtare, për të patur një kornizë ligjore sa më bashkëkohore dhe të përshtatur me ekonominë dhe lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve, në mënyrë të tillë që t'i paraprijë integritet të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Duke analizuar disa nene kryesore të kësaj rregulloreje vë re disa ndryshime thelbësore me Kodin e Procedurës Civile Shqiptare përsa i përket dy çështjeve kryesore: çështjes së derogimit të juridiksionit në fushën civile dhe tregtare dhe pezullimit të gjykimit kur e njëjta çështje civile dhe tregtare është duke u gjykuar nga më shumë se një gjykatë e vendeve anëtare. Zgjidhja që jep në këto raste Rregullorja e Këshillit Europian “Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare” është krejt e ndryshme nga zgjidhja që i jep legjislacioni shqiptar. Legjislacioni shqiptar nuk e lejon derogimin e juridiksionit, heqjen dorë prej tij dhe kalimin me marrëveshje një juridiksioni të huaj, duke bërë kështu një rregullim të ndryshëm nga parashikimi që bën në të tilla raste rregullorja. Sipas këtij akti normativ lejohet që palët me anë të një marrëveshje në fushën e të drejtave civile dhe tregtare të zgjedhin atë juridiksion të një shteti anëtar që i duket më i përshtatshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që kanë lindur ose që do të lindin në të ardhmen. Si rregull, legjislacioni shqiptar nuk e lejon një marrëveshje të tillë dhe nëse lidhet mes dy shtetasve shqiptarë qofshin këta persona fizik apo juridik, do të konsiderohet e pavlefshme dhe nuk do të merret parasysh nga gjykata, por nga ky rregull ka përjashtim, një marrëveshje e tillë do të ishte e vlefshme vetëm nëse lidhet mes një shtetasi të huaj dhe një shtetasi shqiptar person fizik apo juridik pa banim e pa qendrim në Shqipëri, si dhe kur kur këto përjashtime janë parashikuar në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Një tjetër çështje është dhe pezullimi i gjykimit. Sipas rregullores së Këshillit Europian në rastet kur paditë përfshijnë të njëjtën ngjarje dhe ndërmjet palëve të njëjta, juridiksioni ekskluziv për çështje civile dhe tregtare i njihet gjykatës ku ka filluar së pari çështja, ndërsa gjykatat e tjera i pezullojnë këto procedura deri sa të përcaktohet juridiksioni i gjykatës së fillimit. Legjislacioni shqiptar, më konkretisht Kodi i Procedurës Civile nuk parashikon që gjykata shqiptare të pezullojë apo të pushojë gjykimin e një mosmarrëveshjeje kur kjo e fundit ose një çështje e lidhur me të është duke u gjykuar nga një gjykatë e huaj. Pra edhe në rastet kur faktet lidhëse me çështjen objekt gjykimi kanë lidhje me një tjetër çështje që i përket një mosmarrëveshjeje që i përket juridiksionit të huaj. Këtë nen e shoh si shprehje të sovranitetit të Republikës së Shqipërisë, por që duhet ndryshuar për të qënë në koherencë me ndryshimet ekonomike e tregtare të viteve të fundit, marrëveshjeve të shumta që lidhin shtetasit shqiptar, qofshin këta persona juridik apo fizik, me shtetasit e huaj, lehtësimin të qarkullimit civil të mallrave e shërbimeve.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij studimi është nxjerrja në pah e ndryshimeve që legjislacioni shqiptar ka me aktet e Bashkimit Europian në fushën e përcaktimit të juridiksionit në të drejtat civile dhe tregtare, duke filluar nga Konventa e Brukselit e cila daton më 27 Shtator 1968, Konventa e Luganos e vitit 1998 “Mbi juridiksionin dhe Ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare” dhe së fundmi me Rregulloren e Këshillit Europian nr 44/2001 e 22 Dhjetorit 2000. “Mbi juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”, e cila normoi dy konventat e mësipërme. Njohja e saj është e rëndësishme duke patur parasysh prespektivën e Shqipërisë për integrim në Bashkimin Europian. Gjithashtu dhe përmirësimin të legjislacionit shqiptar në këtë fushë për të patur një kornizë ligjore sa më bashkëkohore që i përgjigjet zhvillimeve ekonomike e tregtare të vendit.

Metodologjia

Punimi do të bazohet në metodën e analizës dhe krahasimit të aktve normative ndërkombëtare dhe kombëtare, konkretisht Konventës së Brukselit, Rregullores së Këshillit Europian dhe legjislacionit shqiptar për sa i përket çështjes së përcaktimit të juridiksionit në fushën civile dhe tregtare, duke parë në një këndvështrim krahasues konceptin e Juridiksionit, zbatimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare, konceptin e derogimit të juridiksionit dhe pezullimin e gjykimit në këto fusha.

Analizë

Konventa e Brukselit e datës 27 Shtator 1968 ishte ndër aktet e para që rregulluan fushën e përcaktimit të juridiksionit në çështjet civile dhe tregtare, më pas u miratua Konventa e Luganos e datës 16 Shtatorit 1998, më pas lënda që rregullohej

Jani Vasili, Procedura Civile e Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2005, faqe 25

nga Konventa e Brukselit, u normua nëpërmjet Rregullores së Këshillit të Komunitetit Europian nr. 44\2001 e 22 Dhjetorit 2000. "Mbi juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare". Kjo rregullore zbatohet drejtpërdrejt në vendet e Bashkimit Europian dhe ka zëvendësuar në një masë të madhe Konventën e Brukselit të vitit 1968. Fusha e zbatimit të rregullores është përcaktimi i Juridiksionit të shteteve anëtare të Bashkimit Europian, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve në fushën civile dhe tregtare. Përsa i përket juridiksionit, si rregull i përgjithshëm ai përcaktohet nga vendbanimi i personit në një shtet anëtarë, cilado qofte shtetësia e tij.² Personat që nuk janë shtetas të shtetit anëtarë, por që banojnë në këtë shtet janë nën juridiksionin që zbatohet për shtetasit e këtij shteti. Përveç rregullit të përgjithshëm për përcaktimin e juridiksionit, rregullorja njih edhe përjashtime, të cilat i konsideron juridiksione të veçanta. Pra kemi në këtë rast dy koncepte Juridiksionit i përgjithshëm e juridiksioni i veçantë. Kështu, në lidhje me detyrimet që lindin nga kontratat, juridiksionin mbi këto çështje e ka gjykata e vendit në të cilën duhet të përmbushet detyrimi i kontratës. Në këtë aspekt në rast se palët nuk kanë vendosur ndryshe, duhet të zbatohen kushtet e mëposhtme: Në rast se kontrata ka për objekt dorëzimin e sendeve, juridiksioni i takon gjykatës së vendit ku duhet të dorëzohen sendet. Kur kontrata ka për objekt kryerjen e shërbimeve, juridiksioni i takon gjykatës së vendit ku kryhet shërbimi.

Në qoftë se çështja ka lidhje me një procedim, që ka të bëjë me statusin e një personi, juridiksioni përcaktohet nga gjykata sipas ligjeve të saj, përveç rasteve kur juridiksioni bazohet vetëm në shtetësinë e njëres nga palët. Në çështjet që kanë objekt gjykimi detyrimet jashtë kontraktore, juridiksioni i gjykatës përcaktohet nga vendi ku ka ndodhur fakti i paligjshëm. Në rast se padia civile për dëmin jashtkontraktor bazohet mbi një veprim kriminal, juridiksioni përcaktohet nga gjykata që shqyrton çështjen penale, në masën që kjo gjykatë ka juridiksion sipas ligjit të saj për të shqyrtuar padinë civile. Në rast se gjykimi ka për objekt veprimtarinë e një dege ose filiali të një kompanie, juridiksioni i takon gjykatës në vendin e të cilës dega ose filiali ushtron veprimtarinë e tij. Në rastet e një bashkndërgjyqësie me shumë të paditur, padia mund të ngrihet në vendbanimin e njërit prej të paditurve me kusht që paditë e veçanta që mund të ngriheshin të jenë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që të gjykohen dhe vendosen së bashku, me qëllim evitimin e çdo rreziku të vendimeve që vijnë në kundërshtim me njëra-tjetrën që mund të rezultojnë nga procese të veçanta. Kundërpadia që rrjedh nga e njëjta kontratë ose i njëjti fakt duhet të ngrihet në të njëjtën gjykatë që është ngritur padia. Po ta shqyrtojmë rastet kur objekti i mosmarrëveshjes lidhet me të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga pasuria e paluajtshme, në këtë rast juridiksioni i takon gjykatës së vendit në të cilin pasuria e paluajtshme ndodhet. Në rast se detyrimi buron nga një kontratë sigurimi, juridiksioni i takon gjykatës së vendit në të cilin siguruari ka vendbanimin e tij ose në vendin në të cilin paditësi ka vendbanimin e tij, në rast se padia është ngritur nga i siguruari ose përfituesi në sigurim.³

Po të krahasojmë nenet e rregullores me Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, do të vëmë re diferenca thelbësore për sa i përket ceshtjes se derogimit të juridiksionit për sa i përket të drejtave civile dhe tregtare dhe njohjes së vendimeve dhe pezullimit të procesit gjyqësor kur e njëjta çështje është duke u gjykuar nga gjykata të ndryshme. Zgjidhja që jep në këto raste Rregullorja e Këshilli Europian " Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare " është krejt e ndryshme nga zgjidhja që i jep legjisllacioni shqiptar. Legjisllacioni shqiptar nuk e lejon derogimin e juridiksionit, heqjen dorë prej tij dhe kalimin me marrëveshje një juridiksioni të huaj, duke bërë kështu një rregullim të ndryshëm nga parashikimi që bën në të tilla raste rregullorja. Sipas këtij akti normativ lejohet që palët me anë të një marrëveshje në fushën e të drejtave civile dhe tregtare të zgjedhin atë juridiksion të një shteti anëtar që i duket më i përshtatshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që kanë lindur ose që do të lindin në të ardhmen. Si rregull, legjisllacioni shqiptar nuk e lejon një marrëveshje të tillë dhe nëse lidhet mes dy shtetasve shqiptarë qofshin këta persona fizik apo juridik, do të konsiderohet e pavlefshme dhe nuk do të merret parasysh nga gjykata, por nga ky rregull ka përjashtim, një marrëveshje e tillë do të ishte e vlefshme vetëm nëse lidhet mes një shtetasi të huaj dhe një shtetasi shqiptar person fizik apo juridik pa banim e pa qëndrim në Shqipëri, si dhe kur kur këto përjashtime janë parashikuar në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Ndryshimi themelor që vihet re midis Rregullores së Këshillit të Europës nr 44\2001 të 22 Dhjetorit 2000 dhe Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë është ai i parashikuar në nenin 23 të kësaj Rregulloreje e cila parashikon: Nëse palët, një ose më shumë prej të cilave janë të vendosura në një Shtet Anëtar, kanë rënë dakort që gjykata ose gjykatat e një Shteti Anëtar duhet të kenë juridiksion për të trajtuar mosmarrëveshjet që kanë lindur ose mund të lindin në lidhje me një marrëdhënie ligjore të veçantë, ajo gjykatë ose ato gjykata kanë juridiksion. Ky juridiksion është ekskluziv nëse palët nuk kanë rënë dakort ndryshe. Sipas këtij neni të Rregullores, i njihet mundësia palëve që nëpërmjet një marrëveshjeje të përbashkët, të zgjedhin njërin juridiksion të një shteti anëtar, që u duket më i përshtatshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tyre, që ka lindur ose që mund të lindin në të ardhme. Neni 37\2 i Kodit të Procedurës Civile parashikon: Juridiksioni i gjykatave shqiptare nuk mund t'i kalohet me marrëveshje një juridiksioni të huaj, përveç kur gjykimi ka lidhje me një detyrim ndërmjet të huajve ose ndërmjet një të huaji e një shtetasi shqiptar, ose personi juridik pa banim ose qëndrim në Shqipëri, si dhe kur këto përjashtime janë parashikuar në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Në analizë të nenit 37\2 të Kodit të Procedurës Civile, shohim se ky nen nuk e lejon derogimin e juridiksionit, pra heqjen dorë dhe kalimin e juridiksionit shqiptar një juridiksioni të huaj me marrëveshjen e palëve, duke bërë kështu një rregullim shumë të ndryshëm çështjes së derogimit të juridiksionit, nga normimi që i bën rregullorja nr 44/2001. Ky nen nuk e lejon derogimin ose heqjen dore nga juridiksioni shqiptar pra, nuk lejon që dy persona fizik shqiptar ose dy persona juridik shqiptar me marrëveshje të

Rregullorja e Këshillit të Komunitetit Europian nr. 44\2001 e 22 Dhjetorit 2000. "Mbi juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare".

Alban Brati, Procedura Civile e Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2008, faqe 73.

zgjedhin juridiksionin që i duket më i përshtatshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tyre, megjithatë nga ky rregull ka dhe përjashtim, janë rastet kur flitet për një gjykim që ka lidhje me një detyrim ndërmjet të huajve ose ndërmjet një të huaji dhe një shtetasi shqiptar, ose personi juridik pa banim ose qëndrim në Shqipëri, si dhe kur këto përjashtime janë parashikuar në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Rasti i dytë lejon që nëse ka një marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, t'i kalohet një juridiksioni të huaj e drejta për gjykimin e një çështje të caktuar, por me kusht që gjykimi të ketë lidhje me një detyrim midis të huajve ose midis një të huaji dhe një shtetasi shqiptar ose personi juridik pa banim e qëndrim në Shqipëri. Pra, mosmarrëveshja objekt gjykimi duhet të jetë ose ndërmjet të huajve ose ndërmjet një të huaji dhe një shtetasi shqiptar pa banim ose pa qëndrim në Shqipëri, që juridiksioni i gjykatave shqiptare të mund t'i kalohet me marrëveshje një juridiksioni të huaj. p.sh. Një shtetas Gjerman lidh një kontrat me një shtetas shqiptar (fizik apo juridik) që as nuk banon as nuk qëndron në Shqipëri, por jeton prej vitesh në Itali. Në këtë rast, juridiksionin i gjykatave shqiptare mund t'i kalohet një juridiksioni të huaj, nëse një gjë e tillë është parashikuar shprehimisht në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Le të krahasojmë një tjetër nen të Rregullores 44/2001 të Këshillit Europian dhe legjislacionit shqiptar nën 38 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë. Një tjetër ndryshim mes rregullores dhe Kodit të Procedurës Civile është neni 38 i Kodit, i cili parashikon se: Gjykata shqiptare nuk pushon as pezullon gjykimin e një mosmarrëveshjeje, kur kjo e fundit ose një çështje tjetër që ka lidhje me të, është duke u gjykuar nga një gjykatë e huaj. Sipas rregullores së Këshillit Europian në rastet kur paditë përfshijnë të njëjtin ngjarje dhe ndërmjet palëve të njëjta, juridiksioni ekskluziv për çështje civile dhe tregtare i njihet gjykatës ku ka filluar së pari çështja, ndërsa gjykatat e tjera i pezullojnë këto procedura deri sa të përcaktohet juridiksioni i gjykatës së fillimit. Legjislacioni shqiptar, më konkretisht Kodi i Procedurës Civile nuk parashikon që gjykata shqiptare të pezullojë apo të pushojë gjykimin e një mosmarrëveshjeje kur kjo e fundit ose një çështje e lidhur me të është duke u gjykuar nga një gjykatë e huaj. Pra edhe në rastet kur faktet lidhëse me çështjen objekt gjykimi kanë lidhje me një tjetër çështje që i përket një mosmarrëveshjeje që i përket juridiksionit të huaj. Këtë nen e shoh si shprehje të sovranitetit të Republikës së Shqipërisë, por që duhet ndryshuar për të qënë në koherencë me ndryshimet ekonomike e tregtare të viteve të fundit, marrëveshjeve të shumta që lidhin shtetasit shqiptar, qofshin këta persona juridik apo fizik, me shtetasit e huaj, lehtësimin të qarkullimit civil të mallrave e shërbimeve, si dhe për t'i dhënë mundësi shtetasve shqiptar qofshin këta persona fizik apo juridik të hyjnë në marrëdhënie tregtare apo civile me shtetasit e huaj të barabartë dhe për sa i përket çështjes së përzgjedhjes së juridiksionit të gjykatës së shtetit anëtar që u duket më i përshtatshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që kanë lindur apo që mund të lindin në të ardhmen mes palëve. Neni 38 i K.Pr.C. është shprehje e sovranitetit Shtetëror të Republikës së Shqipërisë, organet gjyqësore të së cilës ushtrojnë sovranitetin brenda territorit të saj dhe formalisht e juridikisht, por as faktikisht, nuk ndikohen nga asnjë veprimtari e organeve gjyqësore të një shteti të huaj, pasi këto organe gjyqësore të huaja realizojnë të njëjtin gjë që bën edhe gjykata shqiptare, pra ushtrojnë funksione juridiksionale që nuk janë gjë tjetër veçse shprehje e sovranitetit shtetëror të shtetit të cilit ato i përkasin.⁴ Kjo dispozitë është shumë e ndryshme nga neni 27 i Rregullores i cili parashikon: Kur paditë që përfshijnë të njëjtin ngjarje dhe ndërmjet palve të njëjta janë ngritur në gjykatat e shteteve të ndryshme anëtare, çdo gjykatë, përveç gjykatës ku është filluar së pari çështja, me iniciativën e saj i pezullon këto procedura deri sa të përcaktohet juridiksioni i gjykatës së fillimit. Në këtë rast kemi konceptin e juridiksionit ekskluziv, i cili i përket gjykatës së fillimit dhe që në të njëjtën kohë detyron të gjitha gjykatat e tjera të shteteve anëtare që në fushën e të drejtave civile dhe aplikimit të ligjit tregtarë të pushojnë çështjen. Pra, siç vëmë re, ky është një formulim krejt i kundërt me neni 38 të Kodit të Procedurës Civile Shqiptare, i cili nuk parashikon pezullimin e gjykimin nga ana e gjykatave shqiptare, kur një çështje e me të njëjtat palë, objekt dhe shkak është duke u gjykuar nga një gjykatë e huaj. Nuk parashikohet nga legjislacioni shqiptar që juridiksioni shqiptar t'i kalohet një juridikoni të huaj. Një tjetër çështje që parashikon Rregullorja dhe dua të trajtoj në këtë punim është marrja e masave të sigurimit të objektit të padisë. Nëse shtrohet për diskut çështja se Cili shtet ka juridiksion për marrjen e masave të sigurimit të objektit të padisë, kur palët me marrëveshje kanë përcaktuar një tjetër juridiksion për shqyrtimin e mosmarrëveshjes? Per këtë çështje është shprehur dhe Gjykata e Lartë me Vendimin nr 22 të Datës 19.01.2011, në të cilin thuhet: Qëllimi i marrjes së masës për sigurimin e padisë referuar si legjislacionit shqiptar, por dhe legjislacionit ndërkombëtar është jo vetëm sigurimi i së drejtës e cila përbën dhe tërësinë e kërkimeve që do të parashtrijë paditësi në padinë e tij, por në të njëjtën kohë dhe ajo që është më e rëndësishmja, është që të sigurojë efektivitetin dhe dobishmërinë e procesit gjyqësor, i cili do të realizohet mes palëve në të ardhmen, në mënyrë që kjo e drejtë të cilën paditësi kërkon të realizojë dhe të njohë nëpërmjet një procesi gjyqësor, të mos jetë e kërcënuar nga një dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm, dhe që vendimi përfundimtar të mos mbetet i paekzekutueshëm. Në analizë të sa më sipër, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmon se pikërisht ky lloj kërkimi, pavarësisht se është në funksion të padisë së themelit është një kërkim i një lloji të veçantë, i cili ndryshon nga kërkimet që paraqiten në padinë e themelit pasi: Siç u tha dhe më sipër qëllimi i vetëm i kërkuesit kur kërkon marrjen e masës për sigurimin e padisë është të sigurojë faktin që vendimi përfundimtar të jetë i ekzekutueshëm dhe që procesi gjyqësor të jetë i efektshëm dhe i dobishëm, kurse me padinë e themelit paditësi kërkon rivendosjen e të drejtave të tij të pretenduara të cënuara apo të shkelura. Gjykimi i kërkesës për marrjen e masës për sigurimin e padisë mund të zhvillohet edhe pa pjesëmarrjen e debitorit, për efekt të shpejtësisë që paraqet ky gjykim, dhe efektshmërisë që duhet të ketë marrja e kësaj mase, parashikuar kjo dhe në neni 205 të Kodit të Procedurës Civile, kurse gjykimi i kërkimeve të themelit që paraqet paditësi me anë të kërkesë padisë nuk mund të zhvillohet pa praninë e debitorit, i cili mban pozicionin procedural të të paditurit, zhvillimi i procesit pa praninë e palës së paditur do ta bënte procesin të cënueshëm dhe jo të rregullt nga pikëpamja ligjore, pasi do të vinte në kundërshtim me neni 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 14, 18, 19, 20, 24 etj. të Kodit të

Procedurës Civile. Prandaj, dhe nga pikëpamja formale në rastin e parë kemi paraqitjen e një kërkesë, kurse në rastin e dytë të një kërkesë padie. Gjykimi për marrjen e masës për sigurimin e padisë është një proces i shpejtë, ku gjykata nuk shqyrton dhe vlerëson të gjitha provat në mënyrë të hollësishme për të parë nëse qëndrojnë apo jo pretendimet e kërkuarit, nëse qëndron apo jo e drejta. Në gjykime të këtij lloji, gjykata vetëm heton nëse plotësohen këto kushte: (a) ekzistenca e mundshme e një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje në procesin e gjykimit të padisë, dhe (b) ekzistenca e frikës, që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë. E kundërta ndodh në gjykimin e themelit të padisë gjatë të cilës gjykata duke respektuar të gjitha normat proceduriale shqyrton në themel nëse ekziston apo jo e drejta e pretenduar nga paditësi, nëse kërkimet e tij janë të mbështetura apo jo në prova dhe në ligj. Në analizë të sa më sipër, Kolegji thekson se edhe nëse do të ekzistojë një juridiksion gjyqësor i gjykatës të huaj për zgjidhjen e konflikteve midis dy palëve dhe ky juridiksion do të jetë i vlefshëm, juridiksioni i gjykatës së huaj do të jetë vetëm për shqyrtimin e kërtimeve të cilat do të kenë lidhje me zgjidhjen në themel të konflikteve që mund të kenë palët si pasojë e mospërbushjes së detyrimeve që ata kanë marrë përsipër, dhe jo për kërtime të llojit siç është sigurimi i padisë, i cili në vlerësim të këtij Kolegji mund të bëhet kudo ku i padituri ka pasuritë/asetet e tij. Ky vendim që unifikon praktikën gjyqësore të vendit tonë është në përputhje të plotë me nenin 31 të Rregullores së Këshillit Europian (KE) nr.44/2001, datë 22.12.2000 "Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare" (*Brussels Regulation, "On jurisdiction and on recognition and enforcement of judgments in civil and commercial matters", Council Regulation (EC) nr.44/2001 of 22 December 2000*) në të cilën thuhet shprehimisht se: "Një kërkesë në gjykatat e shteteve anëtare mund të bëhet për masa të tilla të përkohëshme, përfshirë masa mbrojtëse, siç mund të jenë të disponueshme sipas ligjit të atij shteti, edhe në qoftë se, sipas rregullores, gjykata e një shteti tjetër anëtar kanë juridiksion në lidhje me thelbin e çështjes". Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë arrin në konkluzionin se personi fizik apo juridik i huaj mund t'i drejtohet gjykatës shqiptare me kërkimin për sigurimin e padisë, në rast se pasuria/asetet e të paditurit (debitorit) ndodhet në Republikën e Shqipërisë, edhe pse kompetente për të shqyrtuar çështjen e themelit mund të jetë një gjykatë tjetër e huaj apo arbitrazhi⁵. Pra në të dyja rastet e sipër përmendura kemi një përputhje të plotë për sa i përket raportit mes çështjes së sigurimit të padisë dhe gjykimit të çështjes, cka do të thotë që edhe nëse për zgjidhjen në themel të çështjes kemi një marrëveshje të vlefshme për përcaktimin e një juridiksioni të huaj, për kërkesat e sigurimit të objektit të padisë ka juridiksion shteti në të cilin ndodhen asetet apo pasuritë e debitorit. P.sh në rastin kur dy shtetas gjerman lidhin një marrëveshje që zgjidhjen e konflikteve që mund të lindin në të ardhmen ta zgjidhi një gjykatë italiane, në rastin e kërkesave për sigurimin e padisë dhe jo për zgjidhjen e çështjes në themel, përfshihet në juridiksionin gjyqësor shqiptar me kusht që pasuria apo asetet e tij të ndodhen në Republikën e Shqipërisë.

Konkluzione/ Rekomandime

Rregullorja e Këshillit Europian nr 44\2001 e 22 Dhjetorit 2000, vlen të vlerësohet si instrumenti më i rëndësishëm për përafrimin e legjislacionit shqiptar në fushën e juridiksionit njohjen dhe ekzekutimin në fushën civile dhe tregtare, kjo sepse ka fuqi detyruese për vendet e Bashkimit Europian dhe shtjellon në mënyrë më të detajuar fushën e veprimit të dy Konventave, Konventës së Brukselit të vitit 1968 dhe Konventës së Luganos së vitit 1998, duke rregulluar njohjen e vendimeve. Lënda që rregullohej nga Konventa e Brukselit, u normua nëpërmjet Rregullores. Kjo rregullore zbatohet drejtpërdrejt në vendet e Bashkimit Europian dhe ka zëvendësuar në një masë të madhe Konventën e Brukselit të vitit 1968. Fusha e zbatimit të rregullores është përcaktimi i Juridiksionit të shteteve anëtare të Bashkimit Europian, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve në fushën civile dhe tregtare. Njohja e kësaj rregulloreje është shumë e rëndësishme duke patur parasysh prespektivën e Shqipërisë për integrim në Bashkimin Europian. Megjithëse kjo rregullore nuk ka efekt detyrues për Shqipërinë, mendoj që njohja e saj shërben për t'u përgatitur për një zbatim sa më të mirë të këtyre normave dhe të tjerave që do të miratohen kur Shqipëria të bëhet shtet anëtar i Bashkimit Europian megjithatë zgjidhja për mospërputhjen do të jepet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila në nenin 122/3 të saj parashikon se: Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Repulika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë orgnaizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejt i normave të nxjerra prej saj. Pavarësisht se vendi ynë ende nuk është bërë anëtar i Bashkimit Europian me të drejta të plota, direktivat (rregulloret) e miratuara prej tyre janë udhërfyese në praktikën tonë ligjore. Duhet ndërmarrë hapa drejt procesit të harmonizimit dhe përafrimit të legjislacionit në këtë fushë, duke synuar krijimin e një kornize të mirë ligjore që t'i paraprijë integritet të Shqipërisë në Bashkimin Europian gjithashtu, njohja e saj na shërben për të vënë në dukje ndryshimet thelbësore që ka me legjislacionin shqiptar, për njohje më të thellë ndaj akteve të Bashkimit Europian në këtë fushë dhe përmirësimin e legjislacionit duke u përafruar me aktet ndërkombëtare, për të patur një kornizë ligjore sa më bashkëkohore dhe të përshtatur me ekonominë dhe lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve, në mënyrë të tillë që t'i paraprijë integritet të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Rekomandoj që për sa i përket çështjes së derogimit të juridiksionit, pra heqjes dore nga juridiksioni shqiptar dhe kalimi me marrëveshje një juridiksioni të huaj, të bëhet e mundur lënia në dorë të shtetasve shqiptar qofshin këta persona fizik apo juridik, përzgjedhja e juridiksioni gjyqësor të atij shteti që i duket më i përshtatshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes që ka lindur ose mund të lindin në të ardhmen, kjo për t'u përshtatur me zhvillimet tregtare dhe civile dhe kontratat e shumta që lidhen në këtë fushë. Zgjedhje e cila deri tani nuk është në dorë të subjekteve që lidhin kontratën, por të normave imperative të legjislacionit shqiptar, i cili nuk lejon heqjen dorë nga juridiksioni shqiptar dhe kalimin e tij një juridiksioni të huaj me marrëveshjen e palëve, sigurisht që nga ky

⁵ Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë, nr 22,dt 19.01.2011.

rregull i përgjithshëm ka përjashtim, lejohet marrëveshja për përzgjedhjen e juridiksionit gjyqësor të një shteti anëtar për sa i përket fushës së të drejtës civile dhe tregtare nëse bëhet fjalë për një marrëveshje mes dy shtetasve të huaj, kur flitet për një gjykim që ka lidhje me një detyrim ndërmjet të huajve ose ndërmjet një të huaji dhe një shtetasi shqiptar, ose personi juridik pa banim ose qëndrim në Shqipëri, si dhe kur këto përjashtime janë parashikuar në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë. Rasti i dytë lejon që nëse ka një marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, t'i kalohet një juridiksioni të huaj e drejta për gjykimin e një çështje të caktuar, por me kusht që gjykimi të ketë lidhje me një detyrim midis të huajve ose midis një të huaji dhe një shtetasi shqiptar ose personi juridik pa banim e qëndrim në Shqipëri. Pra, mosmarrëveshja objekt gjykimi duhet të jetë ose ndërmjet të huajve ose ndërmjet një të huaji dhe një shtetasi shqiptar pa banim ose pa qëndrim në Shqipëri, që juridiksioni i gjykatave shqiptare të mund t'i kalohet me marrëveshje një juridiksioni të huaj. Mendoj që e njëjta mundësi zgjedhjeje duhet t'i jepet dhe shtetasve shqiptar, personave fizik dhe juridik që në lidhjen e kontratave mes tyre apo me të huajt të kenë mundësi të zgjedhin juridiksionin gjyqësor që i duket më i përshtatshëm për sa i përket fushës civile dhe tregtare. Çështja e dytë që në opinionin tim ka nevojë për rishikim është pezullimi i gjykimit dhe përcaktimi i juridiksionit ekskluziv si një risi në jurisprudencën shqiptare, duke përcaktuar juridiksionin e gjykatës ku është filluar së pari çështja.

Bibliografia

- Vasili.J, (2005) Procedura Civile e Republikës së Shqipërisë
Brati.A, (2008) Procedura Civile e Republikës së Shqipërisë
Tafaj Kola. F & Vokshi.A (2011) Procedura Civile e Republikës së Shqipërisë
Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”(i ndryshuar)
Konventa e Brukselit nr.41968A0927 (01) “Mbi juridiksionin dhe Ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”, e datës 27 Shtator 1968.
Konventa e Luganos nr. 4198A0592 e 16 Shtatorit 1998 “Mbi juridiksionin dhe Ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”.
Rregullorja e Këshillit të Komunitetit Europian nr. 44\2001 e 22 Dhjetorit 2000. “Mbi juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e vendimeve në fushën civile dhe tregtare”.
Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr.22, datë 19.01.2011

AUDIENCAT E REJA, NDRYSHIMI I RAPORTIT ME PROCESIN E PRODHIMIT DHE KONSUMIMIT TË LAJMIT

ERLIS ÇELA

Universiteti Hëna e Plotë Bedër, Fakulteti i Shkencave Humane, Shkenca

Komunikimi E-mail: ecela@beder.edu.al

ABSTRAKT

Zhvillimi dhe përparimi i mediave të reja dhe kryesisht mediave sociale ka sjellë një raport të ri mes medias tradicionale dhe audiencës. Ky raport ka ardhur duke pësuar ndryshime të mëdha në vitet e fundit, si pasojë e një hapësire të re komunikimi që kanë sjellë mediat e reja, përfshi këtu faqet informative në rrjetet dhe rrjetet sociale. Ky raport nga një marrëdhënie e njëanshme ku oferta që në këtë rast ishte produkt i mediave konvencionale, diktonte dukshëm në formimin e opinionit të audiencës, pa lënë hapësirë për shumë zgjedhje alternative, tashmë ka kaluar një epokë të re ku kërkesa thotë fjalën e fundit. Twitter dhe facebook, si dy aktorët kryesorë të mediave sociale, u ofrojnë përdoruesve të tyre mundësinë që të jenë jo thjesht konsumatorë të produktit që ofron një zinxhir filtrimi në mediat tradicionale, por të marrin pjesë aktivisht nga prodhimi i lajmit deri te përhapja e tij. Është për t'u vënë në dukje fakti se jo çdo informacion i përhapur në facebook dhe twitter është lajm, dhe kjo nuk duhet të krijojë iluzionin sikur realiteti virtual ka zëvendësuar plotësisht kanalet tradicionale të komunikimit masiv. Por, nga ana tjetër, nuk mund të mohohet fakti se këto media të reja kanë transformuar marrëdhënien mes medias tradicionale dhe audiencës së saj. Jean François Fogel dhe Bruno Pinto, shprehen se "tashmë është kërkesa e çdo anëtarit të audiencës ajo që përcakton përmbajtjen e medias". Kjo përbën dhe pikën kulmore të kësaj marrëdhënie.

Ky realitet i ri sigurisht që është hasur edhe në median shqiptare e cila nuk mund t'u shmanget zhvillimeve të reja dhe transformimeve që ndodhin në median botërore. Ky punim synon të shpjegojë pikërisht këtë marrëdhënie të re mes medias tradicionale në Shqipëri dhe audiencës, në raport me zhvillimet e mediave të reja.

Fjalë kyç: *mediat e reja, audiencat, lajmi, facebook, twitter*

Hyrje

Mundësitë e reja që ofron zhvillimi teknologjik në fushën e medias, kanë ndikuar dukshëm në produktin mediatik që i ofrohet audiencës. Media tradicionale janë përballë një presioni shumë të madh që sjellin platformat e reja të informimit të bazuar në web 2.0, e cila ka si llogjikë kryesore interaktivitetin. Në këtë realitet të ri ku, publiku nuk mjaftohet me idenë e të qëndruarit pasiv para ekranit të televizorit apo para një gazete, por kërkon të jetë i përfshirë dhe pse jo ti japi formë produktit mediatik që konsumon. Tashmë, kufijtë mes prodhuesve të përmbajtjeve dhe audiencave po bëhen gjithnjë e më të pakuptueshme dhe kjo ka sjellë edhe rikonceprimin total të rollit të mediave dhe gazetarëve në tregun e informacionit madje riformulimin e vetë komunikimit masiv. (Marku 2014)

Audienca që tani nuk mund të konsiderohet si një e vemte për shkak se kemi një fragmentarizim të jashtëzakonshëm të saj, kërkon bashkëautorë në gjithë procesin e përgatitjes së lajmit deri të shpërndarja e tij. Ka ardhur një kohë e re bashkëkrijimi me “konsumatorët” e informacionit, e prodhimit shumë disiplinor në rrjet, e novacioneve në transmetimin në rrjete. Dhe këtë duket se e kanë vënë re edhe gazetarët profesionistë të cilët gjithmonë e më shumë po kërkojnë rrugët për të përfutur nga mundësitë që ofrojnë mediat sociale.

“Për dhjetëra milionë persona, Facebook- është tashmë porta e hyrjes në Web dhe rrjeti kryesor i komunikimit madje dhe para postës elektronike. Facebook është gjithnjë e më shumë edhe një faqe ku njerëzit informohen: Facebook-u ofron mundësinë të ndërtohet kanalin tënd të transmetimit të informacioneve dhe të bëhet një nga piknisjet më të rëndësishme të trafikut drejt faqeve të mediave” thotë Scherer. ” (Scherer 2012))

Akademiku shqiptar Artan Fuga thotë se tashmë është lënë mbrapa praktika e Gutenbergut, ku ofruesi dhe konsumatori janë dy aktorë komunikimi të ndarë prej njëri-tjetrit. Sipas prof. Fugës, në kushtet e komunikimit interaktiv në internet, gjithnjë e më shumë, shumë individë zotërojnë kompjuterat e tyre, lidhje në internet, telefona të lëvizshëm, dhe në miliarda raste, e prodhojnë vetë ata, ritransmetojnë vetë informacionin e marrë nga media apo të konceptuar në mënyrë krejt të pavarur. Kështu, konsumatori është edhe prodhuesi i përmbajtjes së informacionit.

Në këto kushte, shoqëria ndodhet në mënyrë të vazhdueshme përballë një publiku të lidhur ngushtë me burimet e informacionit, sipas interesave individuale. “Sot konsumatorët dëshirojnë të kenë lajme sipas kërkesës, të përditësuara dhe në vazhdimësi. [...] Hierarkia e informacionit vjen si pasojë e kërkesës dhe e përdorimit të informacionit nga ana e publikut që klikon, ndërsa informimi i propozuar nga redaksitë po zëvendësohet gjithnjë e më shumë nga një informim i dhënë ‘sipas kërkesës’. Nuk është më aq, oferta që komandon kërkesën, por është kërkesa që orienton ofertën.” (Çipuri 2013)

Ky zhvillim ri nuk ka përjashtuar as audencat në Shqipëri. Globalizimi dhe zhvillimi i demokracisë ka bërë që koha kur mediat e reja dhe kryesisht mediat sociale janë shfaqur në vendin tonë të mos ndryshojë shumë me shfaqjen e tyre me shoqëritë e zhvilluara. Për rrjedhojë edhe transformimi i audiencave ka ecur paralelisht me përhapjen e këtyre mediave të reja.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Ndryshimet që kanë sjellë përhapja e rrjeteve sociale kanë prekur jetën e gjithësecilit prej nesh. Eksperienat tona në përballjet me tregun e informacionit, me mjetet dhe platformat e reja ku prodhohet shkëmbehet dhe konsumohet informacion, sjellin me vete dhe nevojën për të hulumtuar më tej mbi raportin që ne kemi me teknologjitë e reja të informacionit, si kanë ndikuar ato në qasjen ndaj mjeteve tradicionale të informimit. Studimet në fushën e medias dhe komunikimit shpesh herë përqëndrohen mbi vetëm aktorët e industrisë së medias, mbi platformat e komunikimit apo siç i njohim ndryshe mbi dërguesin e mesazhit duke lënë disi mënjanë marrësin e këtij mesazhi, pra audiencën e cila në fakt është arsyeja e gjithë zhvillimit të komunikimit. Studimi synon të kërkojë përgjigje mbi disa dilema në lidhje me ndryshimin e sjelljes së audiencës në një mjedis komunikimi të ndryshëm. Dinamika e ndryshimit është marramendëse dhe ndoshta, studimi në këtë drejtim ku të dhenat janë shumë shpejt të ndryshueshme mund të jetë i vështirë, por nga ana tjetër ne nuk mund të qëndrojmë pasiv përpara trendit të revolucionit në industrinë e komunikimit duke mos u kuriozuar sesi ndikojnë gjithë këto ndryshime te publiku. Pyetja që ngrinte John Pavlik në vitin 2001 “se cili është efekti i mediave të reja në marrëdhënien mes gazetarisë (medias) me audiencë?” vazhdon të jetë ende e pranishme. Sot kur po përballemi me revolucionin e medias sociale, pyetja mund të ndryshohet në: cili është efekti i rrjeteve sociale në marrëdhënien e medias me audiencën?

Bashkëautorësia e audiencave, kërcënim apo mundësi

Revolucioni numerik në industrinë e medias që mori formë me web 2.0 dhe më pas me lindjen e rrjeteve sociale, ka mbërritur tashmë në një stad të ri, në të cilin protagonist shfaqet smartphone apo tabletat. Avantazhi më i madh që sjellin smartphonat ka ta bëjë me një “paketim”, “ambalazhim” të gjithë atij informacioni që qarkullon në rrjet, duke e sjellë për përdoruesit në një formë të lehtësuar, me anë të aplikacioneve. Aplikacione të tilla mjaft popullore në ditët e sotme si, Viber, WhatsApp, periscope, BuzzFeed, snapchat e shumë të tjera që përdorim çdo ditë në telefonat apo tabletat që mbajmë në duar nuk janë gjë tjetër veçse një pjesë e informacionit që qarkullon në rrjet e pakëtuar në mënyrë më praktike.

Në këtë mënyrë teknologjia i ka lehtësuar punën jo vetëm përdoruesve të thjeshtë por edhe reklamuesve të cilët paguanin kosto të lartë te operatorët tradicionalë të medias pikërisht për të blerë këtë audiencë të krijuar prej tyre. Studiuesi Mark Cooper nxjerr në pah dy efekte të thella të revolucionit numeric në massmedian komerciale; Roli ndërmjetësues që ndërmarrjet komerciale luajnë në krijimin e një audiencë për t'ia shitur reklamuesit është ndërprerë sepse prodhimi dhe shpërndarja e përmbajtjes në formën e të mirave fizike (gazetat lajme, libra, muzikë cd, stacionet transmetuese), është mënyrë e shtrenjta për të krijuar audiencë. Interneti e bën të mundur krijimin e audiencës në mënyrë shumë më pak të kushtueshme. Për rrjedhojë dhe kostoja që i faturohet reklamuesve është ulur. Efekti tjetër shumë i rëndësishëm lidhet me kosoton e prodhimit e cila falë internetit dhe mundësive teknologjike është ulur ndjeshëm. (Cooper n.d.)

Sipas studiuesit dhe një prej bloggerave më të njohur Dan Gillmor, rregullat e vjetra që njohim në procesin e prodhimit të informacionit kanë ndryshuar. Sipas tij ka vdekur kultura e njoftimeve për shtyp dhe ky duhet të jetë një fakt që duhet të gëzojë pa masë reporterët profesionistë. Ai argumenton se audiencia i ofron çdo ditë e më shumë ide dhe fakte prodhuesve të informacionit dhe kjo ka bërë që të ndryshojë thelbi i komunikimit.

Në 150 vitet e fundit kemi pasur thelb dy kuptime të ndryshme të komunikimit: nga individ-drejt-masës (librat, gazetetat, radiot, dhe TV) dhe nga individ -drejt- individit (letra, telegraf, dhe telefoni).

Interneti, për herë të parë, na ofron dy kuptime të tjera të komunikimit që janë; “nga disa-drejt-disave” dhe “nga një grup i vogël drejt një grupi tejtër të vogël”. Ky ndryshim ka implikime të mëdha për ish audiencën dhe për prodhuesit e lajmeve për shkak se dallimet në mes të dy grupeve janë bërë gjithnjë e më të vështira për të dalluar.

Kjo që po ndodh në media nuk është befasi, duke pasur parasysh natyrën relativisht të hapur të mjeteve të komunikimit, të cilat mund të përdoren në mënyra të cilët as ideatorët e tyre nuk e kishin parashikuar. Ka qenë gjithmonë kështu në media; çdo medium i ri ka befusuar shpikësit e saj në një mënyrë ose në një tjetër (Gillmor 2004)

Në këtë këndvështrim lind pyetje nëse mediat konvencionale si televizioni dhe gazeta po e pranojnë këtë bashkëautorsit të audiencës dhe si po sillen ato në një kohë kur shikojnë që po ju rrëshket nga duart statusi i monopolit në prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit.

Eric Von Hippel një profesor i ekonomisë në Massachusetts Institute of Technology duke bërë një paralele me kompanitë e biznesit rekomandonn se këto të fundit nuk duhet të kenë frikë nga konsumatorët aktivë dhe të zgjaur. Sipas tij këto kompani duhet të bëjnë gjithçka për të inkurajuar interaktivitetin me klientët duke përfutur nga idetë dhe rekomandimet e tyre në funksion të përmirësimit të produktit. Këtë rekomandim Dan Gillmor e sjell në fushën e medias duke argumentuar se gazetarët nuk duhet të ndjehen të fiksuar nga përfshirja e audiencës. Gazetarët nuk duhet të ndjehen të kërcënuar nga një audiencë e informuar pasi kjo tregon se audiencia është e interesuar mjaftueshëm për të përmirësuar produktin. (Gillmor 2004).

Duke qenë në statusin e ri të përdoruesit, publiku ka mundësinë të gjykojë, të zgjedhë, të ndërhyjë në një produkt informativ, të reagojë ndaj një mesazhi apo të ndërveprojë me të tjerët. Disa nga rrjetet sociale me impakt në ndryshimin e raporteve gazetar-audience janë Facebook dhe Twitter. Këto instrumente janë kthyer në një nga mikroblogjet më masiv pasi kanë mbi 50 milion mesazhe të dërguara në ditë. Facebook dhe Twitter u mundësojnë përdoruesve të komunikojnë në kohë reale me njëri tjetrin. Mesazhet mund të përftoheshin, analizohen, agregohen duke plotësuar kontekstin e lajmit, dhe kjo përbën atë që quhet “ambient gazetaresk”. (Lami 2014)

Sipas Gillmor ka tri qendra të mëdha në një botë ku çdokush mund të prodhojë dhe shpërndajë informacione me tekst dhe me video dhe që po përpiqen të mjegullojnë impaktin e njera-tjetrës.

Gazetarët

Gazetarët dhe profesionistët e medias duhet të mesohen me faktin që janë pjesë e diçkaje të re, që lexuesit e tyre / dëgjuesit shikuesit po bëhen pjesë e procesit. Kur lexuesit di më shumë sesa gazetarët publikojnë, ky është një fakt lehtësues, jo kërcënues. Ky është një fakt i mjedisit gazetaresk.

Prodhuesit e lajmit

Në një kohë kur çdokush mund të jetë “gazetar”, shumë njerëz të talentuar do të përpiqen dhe do të gjejnë fakte e detaje që profesionistëve mund tu shkasin/humbasin. Nga ana tjetër politikanët dhe njerëzit e biznesit janë mësuar me këtë çdo ditë. Por prodhuesit e lajmit gjithashtu kanë mënyra të reja për të marrë mesazhin e tyre, duke përdorur të njëjtën teknologji bazë.

Njerëzit në skajet e komunikimit dhe rrjeteve sociale mund të jenë kritikët më efektivë të prodhuesve të lajmeve ashtu siç mund të jenë dhe aleatët më të mirë dhe më të vlefshëm, duke ndarë ide me njëri-tjetrin.

“Ish Audiencia”

Në këtë rast “ish audiencë” nënkupton një status të transformuar tashmë të konsumatorëve të produktit mediatic. Ata tashmë nuk janë thjeshtë “audiencë” por bashkëautorë në proces. Kjo audiencë e transformuar po mëson se si të bëhet pjesë e procesit të gazetarisë, duke qenë aktive në komunikimin masiv dhe në disa raste duke bërë një punë më të mirë se profesionistët. Megjithatë mbi termin “citizen journalism” ka diskutime dhe debate të shumta që mbështesin apo kritikojnë ndikimet në industrinë e informacionit, padyshim që ana më positive e parë nga këndvështrimi i interesit të publikut është fakti se në fund të fundit, ka më shumë zëra dhe më shumë opsione. Pra asgjë nuk mbetet më e fshehtë dhe asgjë nuk mbetet pa u zbuluar.

Dukuritë kryesore të një audience të transformuar

Profesori i gazetarisë, Mark Marku në analizën e tij mbi dinamikat e zhvillimit të audiencës në Shqipëri, pasi bën një shpjegim të etapave nëpër të cilat ka kaluar audiencia shqiptare nga audiencë passive e sistemit mediatic propagandistik në audiencë autonome në ditët e sotme, nxjerr në pah disa tipare kryesore të audiencave të shkaktuara nga teknologjitë e reja dhe platformat e reja të informimit. Autonomia, interaktiviteti dhe fragmentarizimi janë tre dukuritë kryesore që kanë sjellë dhe nevojën për një rikonceptualizim të audiencave. (Marku 2014)

Autonomia e audiencave si një tipar kryesor i një mjedisi mediatic të pasur ku oferta është e shumëllojshme, mund të konsiderohet si moment kyç në zhvillimin e mëtejshëm të industrisë së medias.

Studiuesi i njohur i evolucionit të audiencave, profesori Philip M. Napoli e shikon autonominë e audiencave si një dukuri të lidhur me fragmentarizimin e mjedisit mediatic. Autonomia e audiencave lidhet më shumë me mundësinë dhe aftësinë që ka kjo e fundit për të prodhuar dhe shpërndarë përmbajtje të shumëllojshme në platforma të ndryshme sesa me aftësinë për një vetëkontroll në konsumimin e përmbajtjes. (Napoli 2009)

Nga ana tjetër media tradicionale, nuk ia ka ofruar këtë mundësi interaktiviteti audiencës. Por në kohët e sotme kur teknologjia e ka kthyer informacionin e prodhuar nga përdoruesit (user generated information) në produkt që po konsumohet gjithnjë e më shumë, audiencat po shikojnë përtej kufizimeve tradicionale. Mediat tradicionale ashtu siç e përshkruan dhe akademiku Artan Fuga, i kanë tradhëtuar në një farë mënyre publikun, pasi nuk i jep mundësi atij që të kontribuojë apo të shprehë opinion për përmbajtjen e saj. Në këtë mënyrë ajo krijon një hendek me audiencën. Audiencia nuk e gjen veten në axhendën e medias tradicionale duke i parë temat që shtron kjo e fundit si jashtë interesit të tij apo interesit të gjerë publik. Media klasike e ka «tradhëtuar» qytetarin, në kuptimin që nuk lejon vend që ai të shprehet në të. Ka shkëputje nga audiencia dhe aty gjendet problemi i saj i madh. Ka agjendë që nuk është ajo e diskutimit publik të audiencës. (Fuga 2012)

Ka ekzistuar gjithmonë dilema nëse mund të tolerohet trajtimi i lajmit vetëm si një mall, kryesisht i kontrolluar nga institucionet e konsoliduara, konvencionale mediatike ku gazetarët dhe njerëzit e përfshirë në këtë industri kanë prirje konservatore që nuk lejon ndërhyrjen e audiencave në hapat e këtij procesi. Studiues të ndryshëm kanë vërejtur se ekziston një skepticizim i gazetarëve profesionistë në përgjithësi ndaj risive që sjell teknologjia dhe që ndikojnë në mënyrën sesi ata e ushtrojnë profesionin e tyre. Shpesh bëhet më e vështirë të menaxhosh, filtrosh dhe përzgjedhësh informacionin e postuar në rrjetet sociale apo i prodhuar nga përdoruesit e ndryshëm. Kjo në një farë mënyre ngreh pikëpyetje te gazetarët profesionistë që përfitimi është vërtet aq i madh sa të justifikojë kohën dhe energjinë e harxhuar për menaxhimin e këtij informacioni. (Paulussen and Ugille 2008) Neil Thurman në studimin e tij mbi përfshirjen e përmbajtjes së prodhuar nga përdoruesit në median tradicionale nxjerr në pah faktin se profesionistët e medias kanë njohuri mbi rëndësinë që po merr produkti i prodhuar nga audiencat ose i ndikuar nga reagimi i tyre. Ai nënvizon gjithashtu reagimin e gazetararëve në Britaninë e Madhe ndaj teorisë se blogjet po revolucionarizojnë gazetarinë pasi ato lejojnë interaktivitetin me lexuesit të cilët lënë komente në lajmet e postuara. (Thurman 2008) Komentet përfshijnë reagime mbi temën që raportohet në lajm por gjithashtu edhe komente mbi mënyrën sesi gazetari apo media e ka trajtuar atë fakt apo ngjarje. Në një botë globale ku iniciativa është e lirë dhe ku teknologjia bën të mundur që të gjenerohet informacion pa shumë mund, shoqëria nuk mund të përballojë dot kufizimin e zgjedhjeve madje nuk mund ta përballojë as financiarisht. Profesor dhe akademiku Artan Fuga aspektin e kostos financiare e shikon nga një këndvështrim tjetër. Sipas tij zhvillimet e fundit teknologjike, platformat e reja të komunikimit dhe informacionet në rrjet, kanë sjellë nevojën për një koncept të ri të tregut. Këtu qëndron dhe problemi në lidhje me krizën që ka përfshirë mediat tradicionale. Çmimi i informacionit në hapësirën e komunikimit numerik po bie nga dita në ditë, madje pritet të shkojë drejt zeros. Klientët që dikur quheshin audience, po kërkojnë dhe janë mësuar tashmë me mendësinë e të marrit informacion falas”. (Fuga, Komunikimi në shoqërinë masive 2013)

Konteksti shqiptar, televizioni si pararojë për bashkëpunimin me audiencën

Ndryshimi i raportit të audiencave me industrinë e informacionit ka prekur dhe kontekstin shqiptar. Media tradicionale në Shqipëri, ku përfshijnë kryesisht televizionin dhe gazetatat kanë shfaqur shenja të qarta se e kanë ndjerë revanshin e medias sociale dhe se tashmë nuk mund të mbajnë më monopolin e informacionit. Për këtë arsye janë duke gjetur mënyra për të përfshirë dhe publikun dhe procesin e prodhimit të produktit mediatic. Vetë gazetarët e dinë se tashmë kanalet e komunikimit për audiencën e informacionit, nuk janë faqet kryesore apo mediat tradicionale por më tepër historitë individuale që janë shpërndarë në faqet e rrjeteve sociale. (Thorsen 2013).

Në shumë raste, mediat konvencionale kanë zgjedhur rrugën për të integruar ose për të bërë pjesë të procesit audiencën duke përdorur pikërisht avantazhet që ofrojnë rrjetet sociale. Prodhime të ndryshme televizive që nga edicionet e lajmeve dhe deri te emisionet televizive me të ftuar në studio, nxisin audiencën që të bëhet pjesë e diskutimit, me komente dhe pyetje. Raste të kësaj natyre tashmë i gjen shpesh edhe në median shqiptare. Programe të tilla si, Opinion, Top story, Tonight, Shqip etj, kanë profilet e tyre shumë popullore në facebook, Twitter, instagram dhe rrjete të ngjashme. Drejtuesit e këtyre programeve i kujtojnë shpesh audiencës gjatë transmetimit se ata mund të bëhen pjesë e diskutimit. Madje kjo

marrëdhënie e re shkon deri aty sa temat, komentet apo pyetjet e ardhura nëpërmjet komunikimit në facebook, marrin 1/3 e kohës televizive të programit. Në shumicën e rasteve, autori i pyetjes së drejtuar të ftuarit në studio, i cili është një përdorues i facebook, ka mundësinë të vlerësojë, komentojë dhe reagojë në kohë reale për përgjigjen e marrë. Nëse ai nuk është dakord, apo nuk e ka gjetur të mjaftueshme përgjigjen ka mundësi ta ribëjë pyetjen apo të kritikojë dhe autorin e përgjigjes. Sigurisht që kjo përbën një kthesë rrënjësore përse i përket marrëdhënies mes audiencës dhe medias konvencionale që në këtë rast është televizioni. Nëse kthehem vetëm një apo dy dekada më parë një interaktivitet i tillë ishte i pamundur. Autorët e programeve, gazetarët dhe drejtuesit e medias nuk kishin mundësi të merrnin një feedback kaq të shpejtë nga audiencia.

Rasti i protestave kundra mundësisë së demontimit të armëve kimike në Shqipëri është një tjetër moment që tregon se media tradicionale nuk ka më në dorë formimin, ndikimin apo orientimin e opinionit publik. Protestat nisën nga iniciativa qytetare duke përdorur facebook, madje në një situatë ku televizionet dhe mediat kryesore në vend i kishin dhënë shumë pak hapësirë, për të mos thënë se ishin censuruar duke mos pasqyruar protestat. Vetëm në ditën e 3 të protestave kur po vihej re përhapja e informacionit nëpërmjet rrjeteve sociale, i kishte lënë në një pozitë të vështirë aktorët mediatikë të vendit. Këta të fundit filluan të pasqyronin protestën.

Në kuadër të këtij punimi ne kemi analizuar profilet në facebook Twitter dhe Instragram të dy mediave kryesore, Top Channel dhe Tv Klan dhe jemi përpjekur të shikojmë sesi ato e kanë përfshirë audiencën. Këtu duhet theksuar se krahas profileve zyrtare korporative që përfaqësojnë vetë median si institucion, pjesë e këtij vëzhgimi kanë qënë dhe profilet e hapura nga emisione të veçanta, si Opinion, apo Top Story të cilat në disa raste janë më aktive se vetë profilet e medias ku bëjnë pjesë. Vëzhgimi u krye për periudhën 16 mars deri në 16 prill 2015 dhe synonte të nxirrte në pah sesi komentet dhe ragimet e përdoruesve në llogaritë e këtyre emisioneve përcilleshin apo ndikonin në vetë përmbajtjen e emisionit apo produktit televiziv. Top Channel në Facebook numëron numrin më të madh të ndjekësve me 939,250 persona që kanë pëlqyer faqen dhe sipas statistikave mbi 100 mijë persona në ditë janë aktivë në këtë llogari. Ndërsa Tv Klan numëron 467,205 ndjekës në faqen zyrtare të facebook dhe një numër që varion nga 27-35 mijë përdorues që janë aktivë me komentet, pëlqimet apo ripostimet e informacioneve nga profilet. Në rastin e televizionit Klan duhet theksuar faktin se llogaria e hapur në emër të emisionit “Opinion” numëron 207,264 ndjekës dhe është shumë aktive. Nga ana tjetër emisioni Top Story në Top channel që drejtohet nga gazetari Sokol Balla është më shumë aktiv në rrjetin Twitter duke lënë mënjanë facebook. Në llogarinë e Twitter ky emisioni numëron më shumë se 54 mijë ndjekës dhe ka një nivel të lartë interaktiviteti më komentuesit. Ndonëse nuk ishte pjesë e këtij vëzhgimi duhet thënë se në përgjithësi programet e televizionit Top Channel janë më të prirura drejt rrjetit Twitter në raport me Facebook. Kjo përveçse se një preferencë e drejtuesve të emisioneve është dhe një qëndrim në përputhje me trendin që ndjekin mediat e mëdha botërore. Twitter është më i preferuar nga gazetarët në gjithë botën duke u parë si një sistem alarmi që paralajmëron ata për cka ndodh në aktualitetin e ditës. Studiuesi francez Eric Scherer shikon në këtë qasje një kontraditë. “Gazetarët në gjithë botën parapëlqejnë Twitter dhe janë më shumë aktivë në këtë rrjet. Ndërsa audiencia është në facebook duke parapëlqyer më shumë këtë rrjet. Kjo krijon një shkëputje dhe duhet parë se çfarë pasojash mund të sjellë në të ardhmen.”¹


Top Channel ka një kanal mjaft aktiv edhe në rrjetin Instagram, i cili është i njohur shumë mes moshave të reja dhe i përdorur gjërësisht nga individë që vijnë nga bota e showbiz. Profili zyrtar i Top channel në Instagram ka mbi 21 mijë ndjekës ndërkohë që tv Klan ka një profil më pak aktiv. Në Instagram gjithashtu mund të gesh dhe llogarinë e emisionit “Opinion” i cili numëron mbi 6300 ndjekës dhe që publikon foto të pjesëmarrësve apo momente gjatë debatave televizive.

Gazetari Blendi Fevziu i kushton një rëndësi shumë të madhe mbledhjes së komenteve nga ndjekësit në Facebook në lidhje me temën që është duke u diskutuar në studio. Për këtë arsye gjatë gjithë emisionit mund të dëgjoni disa herë ftesën drejtuar këtyre përdoruesve të rrjeteve sociale për të shprehur qëndrimin e tyre në lidhje me temën. Nga monitorimi i profilit zyrtar në Facebook është konstatuar se vetëm për temën e datës 16 prill që fliste për kandidaturat e sapo shpallura për Bashkinë e Tiranës, 3 postimet e bëra në profilin e Opinion në Facebook morën sëbashku mbi 1800² komente në kohë reale. Zakonisht pjesa e fundit e emisionit shërben për të diskutuar mbi komentet dhe idetë të shprehura nga përdoruesit e rrjeteve sociale. Kjo është vënë re dhe në emisione kur të ftuar janë personalitete të rëndësishme të politikës ish kryeministri apo lideri i opozitës. Në raste të tilla, një e treta e emisionit i kushtohet pikërisht pyetjeve apo komenteve që vijnë nga facebook. Ky fakt vërteton edhe një herë se tashmë audiencia po dikton përmbajtjen edhe në rastin e medias shqiptare.

Në rastin e Top Story, postimet e bëra në profilin zyrtar në Twitter gjatë kohës që emisioni është duke u transmetuar marrin më pak pëlqime dhe komente. Nga monitorimi i bërë është vënë re se numri i pëlqimeve dhe ripostimeve (retweet) për një status, nuk i kalon 7. Nga kjo duket se popullariteti i këtij rrjeti social në Shqipëri është dukshëm i vogël krahasuar me rrjetin Facebook. Megjithatë siç mund të shihet edhe në figurën nr.2, përmbajtja që postohet në rrjet është njëkohësisht edhe në ekranin e televizorit si një përpjekje për të integruar audiencat e ndryshme që ndjekin në të njëjtën kohë programin. Fenomenin e maksimalizimit dhe integritit të audiencave në rrjet dhe atyre që e ndjekin përmbajtjen nga televizori, e vërejmë edhe në rastin e emisionit “Opinion” ku komente të veçanta të bëra nga ndjekës në Facebook shfaqen edhe në ekranin e televizorit.

¹Leksioni i mbajtur nga Prof Eric Scherer në konferencën ndërkombëtare mbi studimet studimet në media dhe Komunikim, 26 mars, 2015, Universiteti Hëna e Plotë Bedër, Tiranë
²Shifrat i referohen datës 15.04.2015. Numrat e komenteve në një postim ndryshojnë vazhdimisht.

FIGURA NR. 1: FRAGMENT NGA EMISIONI OPINION NË TV KLAN




Burimi: Top Channel(2015)

FIGURA NR. 2: FRAGMENT NGA EMISIONI TOP STORY NË TOP CHANNEL



Burimi: Top Channel(2015)

FIGURA NR. 2: FRAGMENT NGA EMISIONI OPINION NË TV KLAN



Burimi: Top Channel(2015)

Konkluzione/ Rekomandime

Kur në vitin 2006 revista prestigjioze Times, mori një vendim që befasoi shumë lexuesit e saj dhe studiuesit e mediave duke shpallur si personalitetin e vitit publikun (audiencën), me siguri konservatorët e skeptikët e botës së re të komunikimit filluan të lëkunden. Kopertina që nga pikëpamja e kreative ishte në makisimumin e vet, kishte vetëm një fjalë “YOU” (ti) pra secili nga lexuesit apo anëtarët e audiencës. “Ju, publiku, lexues dhe përdorues të internetit, keni tashmë nën kontroll moshën e informacionit” shkruhej në artikullin e revistës. Moshja e informacionit është moshja e produktit që mediat i ofrojnë audiencës-konsumatorëve. Sot informacioni është ndoshta produkti më jetëshkurtër që ekziston në treg dhe kjo falë zhvillimit të platformave të reja të komunikimit, rrjeteve sociale dhe teknologjisë së komunikimit në përgjithësi. Aktorët, pronarët e medias, politikanët apo grupet e ndryshme të interesit që veprojnë në mediat tradicionale, nuk kanë më monopolin për të diktuar axhendat. Ne shpesh herë jemi dëshmitarë sesi tema të ndryshme që nuk kanë lidhje me aktualitetin apo që i interesojnë vetëm një pjese të kufizuar të audiencës, merren në diskutim nga mediat konvencionale me ndikimin e aktorëve të ndryshëm që kanë interesa personale apo partiake për tu trajtuar këto tema apo për të bërë të mundur shmangien e vëmendjes nga tema me interes të gjerë publik. Por zhvillimet e reja në hapësirën e komunikimit, përdorimi në rritje i rrjeteve sociale ka bërë që të kemi një profil të ri të audiencës, një profil më kërkuar, që ka marrë në dorë deri diku timonin dhe i dikton apo imponon aktorëve të medias tradicionale drejtimin që ajo ka interes. Sot audiencia për shkak të gjithë argumenteve që sollëm më lart, ka ndryshuar, është transformuar nga një aktor pasiv në një bashkëautor në procesin e prodhimit të produktit mediatik. Audiencia kërkon të mos jetë e mënjanuar por të jetë aksionere e komunikimit. Vrojtimet tregojnë se këtë rol të ri të audiencës kanë filluar ta kuptojnë dhe ta pranojnë edhe aktorët tradicionale të kësaj industrie. Vetë ata pranojnë tashmë që të ndajnë rolin me publikun përsa i përket vendosjes së axhendës në debatin publik. Sfidat mbeten të mëdha sidomos në drejtim të menaxhimit të këtij roli të ri të audiencave. Mbetet të shikojmë se si do të shkojë në të ardhmen kjo marrëdhënie e re mes konsumatorit të informacionit dhe medias.

Bibliografia

- Çipuri, Ramadan. “Ndikimi i audiencave në përmbajtjen e produkteve televizive.” *Studime albanologjike*, 2013: 147-155.
- Cooper, Mark. “The Future of Journalism; Addressing Pervasive Market Failure with Public Policy.” In *The collapse of journalism and what can be done to fix it*, by V. Pickard R. Mchesney, 320–339. New York: The News Press, 2011.
- Fuga, Artan. *Komunikimi në shoqërinë masive*. Tiranë: Papyrus, 2013.
- Media link*. September 2012. <http://www.institutemedia.org/intervista-a-fuga.html> (accessed February 25, 2015).
- Gillmor, Dan. *We the Media Grassroots Journalism by the People, for the People*. Sebastopol, California: O’Reilly Media, 2004.
- Lami, Roland. “Social Media has changed the interrelation between reports and albanian Audience.” *3rd International Conference on education Sciences*. Tirana: Hëna e Plotë Bedër University, 2014. 781-584.
- Marku, Mark. “Dinamika e Zhvillimit të audiencës së mediave bashkëkohore shqiptare.” In *Media në demokratizim*, by Bashkim Gjergji, Gentiana Skura, Iris Luarasi, Jonila Godole, Mark Marku Artan Fuga, 11-32. Tirana: Papyrus, 2014.
- Napoli, Philip M. “Media Policy in the Era of User Generated and Distributed Content: Transitioning from Access to the Media to Access to Audiences.” *Media in Transition Conference Massachusetts Institute of Technology*. 2009.
- Paulussen, Steve, and Pieter Ugille. “User Generated Content in the Newsroom: Professional and Organizational Constraints on Participatory Journalism.” *Westminster Papers in Communication and Culture*. ISSN 1744-6708 (Print); 1744-6716 (Online), 2008: 24-41.
- Pavlik, John V. *Journalism and Neë media*. New York: Columbia University Press, 2001.
- Scherer, Eric. *A na duhen më gazetarët?* Tirana: Papyrus, 2012.
- Thorsen, Einar. “Live Blogging and Social Media Curation: Challenges and Opportunities for Journalism.” *Journalism: New Challenges*, 2013: 123-126.
- Thurman, Neil. “Forums for citizen journalists? Adoption of user generated content initiatives by online news media’.” *Nw Media & Society, Vol. 10, No. 1, pp. 139-157, 2008. Available at SSRN*., 2008: 139-157.

A KA REALISHT NJË NDRYSHIM MES PROPAGANDËS DHE PR-it NË VENDET ME STABILITET POLITIK DELIKAT SIÇ ËSHTË KOSOVA?

NJOMZA KRASNIQI

Kandidat PHD

Hyrje

Një nga temat më interesante për studim është mënyra se si perceptohen dhe zbatohen Propaganda dhe PR-I në vendet që janë me një stabilitet politik ende delikat. Për shumicën e njerëzve këto dy fusha janë të njëjta por në realitet nuk janë. Ndonëse të dyja janë produkte mediatike, të dyja përfshihen në fushën e “opinion maker”, të dyja targetojnë një audiencë të caktuar dhe të dyja manipulojnë pritësin e mesazhit në veprimin e kërkuar ato kanë një ndasi themelore që është E VËRTETA.

Në rastin e propagandës kemi një mesazh të shtrembëruar që mund të ketë një farë vërtetësie ose jo dhe që jepet si mesazh për të manipuluar opinionin public në një mënyre ose në një tjetër. Ndërsa në rastin e PR-së kemi përhapjen e një mesazhi të vërtetë që realisht ndikon në ndërtimin e një marrëdhënieje besimi midis një organizate dhe produkteve të saj më audiencën e targetuar. Pika më e fortë që dallon këto të dyja është fakti se mesazhi i PR-it është lehtësisht i vërtetueshëm ndërsa ai i Propagandës nuk ka shumë hapsirë për vërtetim.

Por në rastin e vendeve në zhvillim ekonomik dhe destabilitet politik siç është Kosova këto linja që janë në përgjithësi të qarta kthehen në më problematike dhe të lëbturura. Ajo çfarë është më interesante është se dhe vete institucionet që janë mbarteset e këtij mesazhi nuk janë gjithmonë të qartë në tejçimin e këtij mesazhi. Ky punim është një studim në këtë fushë. Fokusi është në pyetjen nëse ka realisht ndryshim mes Propagandes dhe PR-it në median e Kosovës, dhe nëse jo ashtë kjo një kulturë që vjen nga transformimi politik i shoqërisë apo një byproduct i gjeneruar nga mungesa e një kulture politike.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij studimi është paraqitja se si PR dhe propaganda përfaqësohen në median e Kosovës dhe se si kultura dhe historia e tyre kanë ndikuar në perceptimin e tyre. Gjithashtu në bazë të të dhënave të mbledhura mund të provojmë deri diku se si ndikon transformimi politik dhe kultura politike në perceptimin e saktë dhe përdorimin e këtyre të dyjave në situatën aktuale në Kosovë.

Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Ky punim është një përshkrim i situatës që është aktuale në Kosovë e bazuar më dhëna të ndryshme të mbledhura përmes burimeve të ndryshme, kryesisht statistikore të cilat janë të detajuara më në thellësi në pjesën e pestë.

Hipoteza jonë është: A luan rol transformimi politik apo mungesa e një kulture politike në mënyrën se si përdoret dhe kuptohet propaganda dhe PR, në median e Kosovës?

Rëndësia e Punimit

Nivelet shoqërore, sociale dhe individuale të ndryshimit në çdo vend post-komunist janë të integruara në tërësi sistematike nga ana e karakteristikave të përbashkëta kulturore, të rrënjësura pjesërisht në kulturën kombëtare, por në të njëjtën kohë ndikuar fuqimisht nga kultura gjithë-evropiane, mjedisi dhe ndikimi nga proceset globale.²

Ndryshim politik në 1989 nuk ishte nga autokratikët, regjimet mono-partiak ndaj parlamentare, sistemeve shumëpartiake - ishte fitorja përfundimtare e demokracisë.

Ky nuk ishte një transformim radikal i institucioneve, as kthimi i disa socialistëve të më herët, apo urdhër - “kthimi” në Evropë, në përfundim, për në “normalitet”. Përkundrazi, ajo filloi rindërtimi e një rendi të ri shoqëror nga një përzierje të çuditshme të komponenteve të ndryshme.³

Kjo situatë bëhet akoma më intriguese në aspektin e Kosovës. Kosova jo vetëm që vjen nga një sitem politik komunist por është dhe një vend relativisht i ri në aspektin e vetëqeverisjes. Konfrontuar me këto të dhëna,

shfaqja e ngadaltë e një kulturë të re post-komuniste dhe qytetërimit⁴, PR është një term i panjohur në komunikimi, por menaxhimi i komunikimit dhe propaganda kanë ekzistuar. Në një shoqëri komuniste dhe të robëruar, mund të themi se disa mënyra të PR-it janë veprim ideologjik. Për më tepër, profesionistët e PR në shoqëritë demokratike mund të, në qoftë se fati idërgon ata që të jetojnë në një shoqëri totalitare, marrin punën e organizatorit. Dallimet janë politike dhe ideologjike, ekzistuese në një nivel botëkuptimi, (Botëkuptimi komunist apo demokratik, botëkuptimi simetrik apo asimetrik, etj), por në një tekniko nivel taktik, punët janë shumë të ngjashme.

Bazuar në këtë më poshtë është një diagramë që tregon sa media në Kosovë përdor Propagandën dhe sa përdor Pr-in në paraqitjen e realitetit politik. Të dhënat janë marrë nga një sondazh i Gazetës, Pristina insight, në 2012, me të drejtë publikimi, pasi sondazhi i bërë nga ta që për arsye studimi të avancimit të liberalizimit të mediave në Kosovë, i sponsorizuar

Baudrillard, J. (1990). Hakmarrja e Chrystal. Londër dhe Concord, MA: Plutoni Press p.88 (Lauristin et al 1997: 26).

Best, S. & D. Kellner (1991). Teoria postmoderne: Kritik Intevrolations (New York: Guilford Press) (Sztompka, 1996: 120)

Best, S. & D. Kellner (1991). Teoria postmoderne: Kritik Intevrolations (New York: Guilford Press)

nga USAID. Të dhënat e meposhtme ndonëse janë marrë nga i njëjti institucion publikohen për herë të parë në këtë mënyrë. Pasuesi i zhvillimit të fushës së PR ishte kryesisht apatik, letargjik dhe i njëanshëm dhe ishte më shumë i lidhur me zhvillimet në ekonominë, politikën dhe gazetarinë. Një prej hipotezave për lindjen e PR është se vetëm “ndikimi” i gazetarisë dhe presioni publik social frymëzuan profesionistët e PR për të përcaktuar fushën e tyre, që tregon ndikimin social dhe shoqëror. Presioni ishin faktorë me ndikim në fushën e marrëdhënieve publike siç ishin pasiguritë e botës bashkëkohore, kriza ekonomike, konfliktet politike dhe luftërat, si dhe ndryshimi i klimës kanë ndryshuar rrethanat ku PR aspiron të paraqesë legjitimitetin e raportimit. Vëmendja tani është kthyer në drejtim të të vënit në dyshim legjitimitetin e çdo raportimi dhe çdo veprim. Si të gjitha vendimet shoqërore janë vënë në provë në ndikimin e Opinioni publik, marrëdhëniet publike luan një rol të madh në zgjidhjen e rasteve të interesave në shoqëri. Funlsioni social i PR “ është vendosur kur ajo zëvendëson injorancën, shtrëngimin, papajtueshmërinë me dije, kompromisin dhe rregullimin. Marrëdhëniet me publikun ka një ndikim në sjelljen individuale, organizative, dhe sociale të gazetarëve. Ata që janë të angazhuar profesionalisht duke ndihmuar organizatat identifikojnë, të krijojë, dhe ruajnë marrëdhënie të ndërsjelltë të dobishme me aktorët kryesorë të shoqërisë për të kryer një funksion të menaxhimit që ka një ndikim në shoqëri gjithmonë e më të madh. Kjo përgjegjësi sociale motivon nritjen e interesit në PR dhe rritjen e njohjen ne thelb të saj.

Nevoja për të komunikuar

Që një demokraci të funksionojë në mënyrë efektive, qeveria duhet të komunikojë me qytetarët e vendit. Ata kanë të drejtë të dinë se çfarë ministritë e qeverisë dhe organet e tjera të sektorit publik janë duke bërë, dhe pse vendimet administrative janë bërë. Informacioni i dhënë nga qeveria duhet të jetë i besueshëm dhe në kohë. Për të arritur një numër të madh të njerëzve, qeveria duhet të mbështetet në media,

E cila filtron dhe analizon informacionin e dhënë në publik në mënyrë elektronike ose në shtyp. Reforma e administratës publike kërkon një reformë paralele të rolit të përgjegjësive qytetare. Udhëheqësit e reformës së administratës publike duhet të komunikojnë me publikun, ti informojnë ata lidhur me ndryshimin e roleve ndërmjet qytetarëve dhe administratës dhe çfarë të presin nga ndryshimi. Ekziston një nevojë në të gjitha nivelet e shoqërisë për një përkufizim themelore në të kuptuarit e:

Roleve specifike të organeve të ndryshme të administratës publike;

Kufijtë e këtyre roleve; dhe

Sanksionet në dispozicion për publikun në rast të mos-performancës nga ata që kanë përgjegjësitë në sektorin publik.

Ky proces i përkufizimit dhe mirëkuptimit duhet të fillojë me udhëheqësit politikë dhe shërbëtorët e publikut. Në të njëjtën kohë, diferenca në rolet mes të korrupsionit të kontrolluar të shërbimit civil dhe atij të pakontrolluar⁷ që është një veçori e vendeve pos dictatoriale duhet të jenë të përcaktuara.

Mbi të gjitha, çdo përpjekje duhet të bëhet për të ndërtuar besimin mes administratës publike,

qytetarit të lirë, dhe medias. Qytetarët individualë duhet të kuptojnë shërbimet e ofruara nga administratat dhe trajnimin si dhe të rrisin nivelin e llogaridhënies duke krijuar standardet e reja të aplikuara për nëpunësit civilë. Kjo do të ndihmojë që të çmitizojmë kulturën e vjetër të sektorit publik ndërsa do të luajë një rol të konsiderueshëm në ndërtimin e respektit dhe mbështetjen e organizatave të jashtme për të vazhduar procesin e transformimit ekonomik dhe politik.

E gjithë kjo që pasqyroam më sipër është një induktim i faktit se jo gjithmonë e kemi situatën në kontroll dhe sado që mundohemi të anashkalojmë traditat e vjetra, pa vendosur një komunikim të mirrëfilltë mes të dyjave është e vështirë që të arrijmë një ndryshim në kalimin nga propaganda te PR, gjatë kësaj periudhe.

Është e domosdoshme të arihet një transparence mes të dy llojeve të komunikimit jo vetëm për arsye të ndryshimeve që duhet të arrihen në metodologjitë e trashëguara por edhe sepse:

Nëpunësit publikë duhet të mësojnë teknikat themelore të komunikimit për trajtimin me mediat dhe kanale të tjera komunikimi si mjete për ndërtimin e konsensusit dhe mbështetje për reforma administrative.

Menaxherët e medias kanë nevojën e sektorit privat për të përmirësuar të kuptuarit e rolit të

sektori publik dhe problemet e reformës, dhe për të marrë në konsideratë interesimin e mundshëm të klientëve të tyre që

kanë të bëjnë me çështjet e sektorit publik.

Roli i Mediave

Mediat vepron si një kanal komunikimi dhe si një pjesëmarrës aktiv në procesin e reformave.

Roli i dytë që ka luajtur është ai që nese nuk ka një program të komunikimit të qeverisë media mund të krijojë programin e vetë dhe mund të jetë pozitiv ose negativ. Pyetja për qeverinë është se si duhet ta përcjellë mesazhin e saj për media, i cili ushtron një fuqi të madhe të pushtetit në çdo demokraci.⁸

Qeveritë dhe administratat duhet të mësojnë që të tolerojë dhe të vlerësojnë rolin e një media të pavarur në procesin e

Castells, M. (1997) . Fuqia e Identitetit . Oxford , dhe Malden , MA: Blackwell .

Castells , M. (2000) . Materiale për një Teoria eksploruese të Shoqërisë Rrjetit . britanik

Castells , M. (2000) . Materiale për një Teoria eksploruese të Shoqërisë Rrjetit . britanik

reformës si një furnizues esencial të reagimeve, si dhe një kanal komunikimi. Efektiviteti i mediave në rolin e saj si kanal komunikimi varet, megjithatë, për gjendjen e përgjithshme të mediave - si për realitetin dhe perceptimin e pavarësisë së saj.

Ata që janë në sektorin publik duhet të aplikojnë një numër të parimeve dhe teknikave të përgjithshme gjatë komunikimit me mediat:

Ndërtimi i konsensusit si Fondacioni për zbatimin e politikave, roli i propagandës dhe PR-it

Qeveritë dhe grupet reformatore duhet të “lobojnë” për mbështetjen e reformave të tyre. Kështu, një program i herët në shënjestër të grupeve të ndryshme të presionit⁹ si për ndryshimin e roleve dhe përgjegjësi

në mes të sektorit publik dhe privat mund të ndihmojë për ta bërë punën e re të sistemit të politikave publike në mënyrë më efektive.

Të gjitha analizat në shtyp dhe kontaktet nuk duhet të jenë ngjarje të lajmeve. Është helbësore, edhe pse, për të zhvilluar ndjenjën e një “bashkëpunimi” me audiencat që ju doni të ndikoni në mënyrë që ata të ndjehen se ata konsultohen dhe se janë të informuar për atë që po ndodh.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme në mjedis kompleks të medias në Europën Qendrore dhe Lindore ku ka diversitet të madh dhe një ambient “të lirë-për-të gjithë”, dhe ku media është krijuesi për kredibilitetin e vet duke demonstruar aftësinë e saj për të kritikuar në një mënyrë konstruktive.¹⁰

Roli i historisë botërore në zhvillimin e marrëdhënieve me publikun ka rëndësi të madhe të studiohet për të kuptuar zhvillimet e tyre në shekullin e 20. Shpesh procesi i “marrëdhënie me publikun” në ndërlidhje me mënyrën e zhvillimit global të ekonomisë janë raporte zhvillimi të nevojshme. Gjysma e dytë e shekullit të 19 tregoi fillimin e revolucionit industrial, i cili ishte i aftë të ndikojë në nivelin makro të tregtisë globale dhe ekonomitë e Evropës dhe SHBA. ¹¹Në nivelin mikro, revolucionin industrial bëri të mundur lindjen e një nevojë të madhe për të menaxhuar marrëdhëniet organizatave me palët e tjera, veçanërisht me klientët por edhe me median dhe sferën publike. Nevoja socio-ekonomik në shoqëritë demokratike për komunikim dhe ndërveprim dhe zhvillimit të mëtejshëm të marrëdhënieve ishte mjaft konkrete. Në këtë kontekst është logjike që kjo nevojë i dha mundësi lindjes së termit “marrëdhënie publike” të Gan në fund të shekullit-të19. Megjithatë, nuk mund të kundërshtojmë se ndonëse si term përdoret në mënyrë të mirëfilltë në fund të shekullit të mësipër, “marrëdhëniet publike” si një “filozofi operative” mund të ketë ekzistuar edhe më herët.¹²Ka pasur pesë ndryshime të dallueshme pragmatik në marrëdhëniet me publikun gjatë shekullit të 20. Që në fillim të 1928, Bernays deklaruar se PR dhe propaganda janë të njëjta. Por konteksti në të cilin Bernays dhe Goebbels kishin bërë këto deklarata janë krejtësisht të ndryshme. ¹³Fakti bazë është se këto dy forma të komunikimit, të cilat ndërhyjnë në të gjitha proceset e komunikimit janë të ndryshme. Pas praktikave e konkrete të komunikimit dhe të ndërtimit të marrëdhënieve me publikun në shtetet totalitare, (dmth fashiste Gjermania, Spanja dhe Italia, dhe Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Ballkanit) dhe pas deklaratave konkrete ideologjike të liderëve totalitare ishte e qartë se ideologjia e marrëdhënieve publike ishte e papërshtatshme për ideologji totalitare. Me fjalë të tjera, propaganda dhe marrëdhëniet me publikun nuk e ndajnë të njëjtat vlera.

Si pasojë, një përfundim logjik ishte se PR nuk ka të bëjë asgjë me propagandë ndonëse, siç propaganda është vetëm një mjet, propaganda ka një vlerë ambivalente. Nuk është as e keqe as e mirë. Konotacione historikisht pozitive të propagandës u çmontuan si rezultat i ideologjive totalitare. Ky argument ishte mjaft i fortë dhe shërbeu për të ndarë marrëdhëniet publike nga propaganda në vitet 1930. Oeckl pas Luftës së Dytë Botërore, kur studiuesit gjithmonë e më shumë donin të bënin dallimin në mes të marrëdhënieve të mira publike dhe propagandës së keqe, e mbështetën këtë qasje.

Revolucionet sociale të dekadave të para të shekullit të 20 bënë një darje të të gjitha kombeve në dy sisteme politike, demokracisë dhe totalitar, ndarje e cila vazhdoi deri 1990. Çdo sistem politik ka gjithmonë ideologjitë bazë të cilat janë bazuar në vlerat kryesore mbui të cilat është ndërtuar vetë sistem; Sartori ¹⁴identifikon gjashtë kushtet më të rëndësishme të një shoqërie totalitare: (I) ideologjia zyrtare; (II) vetëm një parti në masë të kontrolluar byano ligarchy; (III) një qeveri me kontroll monopolist apo vendosur në bazë të ushtrisë(forcat e armatosura); (IV) një qeveri me kontroll monopolist apo vendosur në bazë të kontrollit të medias; (V) një sistem policor terrorist (milicia) dhe (VI) një ekonomi e menaxhuar nga qendra. Colin Sparks në studimin midis komunizmit, kapitalizmit dhe mediat masive, vë në pah se esenca bazë e ndryshimit është se në një sistem komunist një nga termat më shumë të saktë që mund të përdorim për të pasqarua kontrollin e tyre ndaj medias është “totalitare”, dhe në këtë aspekt mund të pohojmë fare lehtë se PR nuk ekziston në këtë menaxhim por vetëm propaganda. Sparks argumenton se marrëdhënia e shoqërisë me masmedia karakterizon dallimin në mes të një shoqërie komuniste dhe një shoqërie kapitaliste demokratike. Për më tepër, në një shoqëri demokratike, ekonomia dhe politika janë të ndara; Ana ekonomike është e përfaqësuar zakonisht nga interesat private, dhe politikanët i përqendrojnë përpjekjet e tyre ndaj interesit publik dhe mirëqenies publike.

Kontrolli dhe pushteti janë të ndarë në mes grupeve shoqërore në një

Sztompka, P. (1996). Looking back: the year 1989 as a cultural and civilizational break. *Communist and Post-Communist Studies*, 29 (2), 115-129

Castells, M. (1989). *Informational Qyteti: Teknologjia e informacionit*, Ekonomik

Baskin & Aronoff (1992). *Marrëdhëniet me Publikun*. WBC publikime

Castells, M. (1989). *Informational Qyteti: Teknologjia e informacionit*, Ekonomik

Baskin & Aronoff (1992). *Marrëdhëniet me Publikun*. WBC publikime

Baskin & Aronoff (1992). *Marrëdhëniet me Publikun*. WBC publikime

shoqëri demokratike. ¹⁵Sparks përcakton totalitarizmin si vijon: Një sistem totalitar është një sistem në të cilin udhëheqja e centralizuar elitë ka një gamë të gjerë të instrumenteve të avancuar teknologjike që implikojnë pushtetin politik në mënyrë që të implikojnë, në bazë të bazave arbitrare ideologjike të vendosura nga udhëheqësit, revolucionit social, gjithashtu për të punuar mbi njerëzit fiziologjikisht në një atmosferë të unanimitet që ka qenë mbi të gjitha e detyruar ¹⁶.

Shtetet totalitare, gjatë mesit të shekullit të 20 dhe veçanërisht pas Luftës së dytë botërore gradualisht u bënë më të mbyllura dhe u zhvendosën drejt entropisë. Kontrasti bazë ishte mjedisi social i shteteve demokratike të bazuar në lirinë e fjalës, transparencës, freeelections etj që ndikuan në krijimin e një mjedisi më elitare e gjithëpërfshirës ¹⁷.

Propaganda mund të shërbejë për të mbledhur njerëzit pas një arsyeje, por shpesh me koston e ekzagjerimit, shtrembërimit, ose madje edhe duke gënjyer në lidhje me çështjet në mënyrë që të fitojnë atë mbështetje. Ndërsa nga ana tjetër PR, kërkon një pjesmarrje të drejtëpërdrejtë nga masmedia dhe qytetari duke bërë në këtë formë që të jetë e bazuar në një formë të fakteve bazë më shumë se sa ideologji.

Ndonëse çështja e propagandës shpesh është diskutuar në kontekstin e militarizmit, luftës dhe luftë-mbështetjes, ajo është rreth nënë në të gjitha aspektet e jetës.

Si shembuj të ndryshëm më poshtë janë pasqyruar taktika të zakonshme të bazuara në propagandën shpesh të përdorur nga të dyja anët që përfshijnë:

Duke përdorur histori selektive që vijnë në sitë apo gjysëm të pjesëshme dhe që pëstjellojnë objektivitetin.

Fakte të pjesshme, ose konteksti historic të veçantë.

Përforcimi i arsyeve dhe motiveve për të vepruar për shkak të kërcënimeve për sigurinë e individit.

Burime të ngushta të “ekspertëve” për të ofruar njohuri ndaj situatës. (Për shembull, mediat kryesore në mënyrë tipike botojnë intervistat e personelit ushtarak të dalë në pension për shumë çështje lidhur me konflikte të ndryshme, apo trajtojnë burimet zyrtare qeveritare si fakt, në vend se ti drejtohen me një perspektivë që duhet të verifikohen dhe hulumtuar, siç është lufta e Kosovës) ¹⁸.

Demonizimin e “armikun” i cili nuk përshtatet me mënyrën se si ne e perceptojmë atë që është “e drejtë”.

Duke përdorur një gamë të ngushtë të diskursit, ku gjykimet janë bërë më të shpeshta ndërsa kufiri i diskursit vetë, ose kuadrin brenda të cilit janë formuar opinionet, as që diskutohet fare por anashkalohet si një raportim i drejtëpërdrejtë i fakteve. Fokusi i ngushtë pastaj ndihmon për të shërbyer interesat e propagandistët. Disa nga seksionet e mëposhtme shohim në se si propaganda është përdorur në mënyra të ndryshme, duke zgjeruar në listën e mësipërme të taktikave dhe pajisjeve. ¹⁹ Ottosen identifikon disa faza kryesore të një fushatë ushtarake për të “zbutur” deri opinionin publik përmes medias në

përgatitje për një ndërhyrje të armatosur. Këto janë:

Faza-afatgjatë paraprake që vendi në fjalë portretizohet në lajme, portretizohet si një shkak për “ritje shqetësimi” për shkak të varfërisë / diktaturës / anarkisë;

Faza Arsyetimi -gjatë të cilit lajmi i madh është prodhuar për të dhënë ndihmë urgjente me rastin e intervenimit të armatosur për të sjellë një rikthim të shpejtë të “normalitet”;

Faza Zbatimi -kur bashkimit dhe censurim të sigurojë kontrollin e mbulimit;

Pasojat-gjatë të cilit normalizimi situata është portretizuar si qetësia është kthyer në rajon, para se ai edhe një herë të mos përmendet më në axhendën e lajmeve.

O’Kane ²⁰ vëren se “ka gjithmonë një histori me fëmijë vdekur”, dhe se kjo histori vjen në pikën kyçe të Faza Arsyetimi -në formën e një historie apo libri i cili ka vonesë dhe jo koherence-veçanërisht për shkak të urgjencës së qartë dhe mungesës së domosdoshme të kohës për një shqyrtim të ftohtë të situatës apo për të negociuar mbi mundësitë dhe propozimet e paqes. Tregimet e që e vënë theksin te interesi i njeriut ... janë ideale për të detyruar publikun që të mosveprojë lidhur me mekanizmat e tjerë të arsyesimit dhe të japi veton e vetë pa qenë në dijeni të situatës aktuale.

Ushtaria shpesh manipulon mediat kryesore, duke kufizuar apo menaxhimua çfarë informacioni është paraqitur dhe kështu çfarë informacioni është dhënë publikisht. Për ta është e lehtë për të kontrolluar mediat. ²¹ Kjo mund të përfshijë të gjithë mënyrën e veprimtarive, nga organizimin e seancave të mediave dhe njoftime të përditshme të shtypit, apo për të siguruar qasje të menaxhuar në zonat e luftës, duke siguruar në këtë formë edhe mbjelljen e historisë. Kjo ka ndodhur gjatë gjithë shekullit të 20-të. Me kalimin e kohës pastaj, mënyra se media mbulon konfliktet degradon në cilësi, kritikë dhe objektiviteti.

“Informacioni është monedha e fitores”, thuhet në publikim e një gusht 1996 të ushtrisë së SHBA në manualin e ndërveprimit në terren. Nga perspektiva e një ushtrisë, luftë për informacionin është një tjetër front në të cilën një betejë duhet luftuar. Megjithatë, ashtu sic kanë nevojë për të mashtruar kundërshtarët, për të ruajtur mbështetjen publike, ashtu edhe informacioni për publikun e tyre duhet pa dyshim të menaxhohet. Kjo ka kuptim nga pikëpamja ushtarake. Ndonjëherë publik mund të jetë i gatshëm për të sakrifikuar njohuri të detajuara. Por një situatë e tillë mund të çojë gjithashtu në papërgjegjësi dhe kur informacioni që paraqitet është menaxhuar në binarë të tillë në fund rezultati më i shpeshtë është,

Lauristin, M., Vihalemm, P., Rosengren, K.E., Weibull, L. (eds.) (1997), Return to the Western World. Cultural and Political Perspectives on the Estonian PostCommunist transition, Estonia: Tartu University Press

Baskin & Aronoff (1992). Marrëdhëniet me Publikun. WBC publikime

Lauristin, M., Vihalemm, P., Rosengren, K.E., Weibull, L. (eds.) (1997), Return to the Western World. Cultural and Political Perspectives on the Estonian PostCommunist transition, Estonia: Tartu University Press

Baskin & Aronoff (1992). Marrëdhëniet me Publikun. WBC publikime

Baskin & Aronoff (1992). Marrëdhëniet me Publikun. WBC publikime

Baskin & Aronoff (1992). Marrëdhëniet me Publikun. WBC publikime

Ristrukturimi dhe Procesi Urban - rajonal. Oxford dhe Cambridge, Mass.: Blackwell.

propaganda. Beelman gjithashtu përshkruan se si kjo formë e ashtuquajtur Menaxhimi i Informacionit të Operacionit është përdorur për të menaxhuar informacionin²².

Lufta e Kosovës dhe ajo boshnjake u karakterizua nga mbulime sensacionale, manipuluese, të njëanshëm, dhe nganjëherë të shtrembëruar të medias. Gazetari francez Jacques Merlino ishte një nga të parët për të analizuar fushatën sistematike propagandistike të Luftës Civile boshnjake. Në 1993, Peter Brock përshkruar mbulimin mediatik amerikan të Luftës Civile boshnjake në iDateline Jugosllavi: The partizane Pressi (Politika e Jashtme, Einter 1993-1994) si vijon:

Lexuesit dhe shikuesit kanë marrë raportet më të gjalla të mizorisë, tragjedisë, dhe barbarizmit...

Ky ishte një sulm i paparë dhe i paepur, duke kombinuar teknikat moderne të mediave me gazetarinë avokimit ... media u bë një lëvizje, një bashkë-palë ndërluftuese me palët e tjera dhe nuk është më e maskuar si jopjesëmarrëse dhe jopartiake. Lajmet e publikuara gjatë luftës së Bosnjës dhe asaj të Kosovës kanë qenë shumë të detajuara dhe mizoria, terrori dhe barbarizmi janë bërë publike në mënyrë më të detajuar të mundshme. ²³Qëllimi ishte i qartë , detyrimi i domosdoshëm i qeverive që të ndërhyjë ushtarakisht.

Këtë përshkrim të rolit të mediave amerikane në një ndërhyrje të kujdesshme të Luftës të Kosovë dhe Luftës në Boshnjë mund ta gjeni të përshkruar saktësisht në Heartis Journal dhe Pulitzeris nga 1895 deri 1898, ku historitë më të vlerësuara ishin historitë e luftës dhe mënyra se sat ë detajuara ishin këto histori. Hearst dhe Pulitzer, gati njëqind vjet më parë imituesit e tyre të mëparshëm, kanë përdorur saktësisht të njëjtat teknika mediale dhe të njëjtat metodat që janë përdorur në mbulimin e konfliktit në Bosnjë. Pra Brock nuk është plotësisht i saktë kur ai thotë se kjo metodë e mënyrës së raportimit është e pashembullt. Në fakt, kjo ka qenë model i gazetarisë amerikane të paktën që nga koha e Hearst dhe Pulitzer²⁴.

Artikujt sensacionale, inflamator, dhe propagandistike dhe editorialet në Hearstis Journal dhe Pulitzeris bënë shumë për të nxitur hysterinë e luftës dhe në fakt ka shumë element që tregojnë se këta artikuj ishin një nga mënyrat që ndikuan më së shumti për të shkaktuar një luftë të panevojshme me Spanjën. Hearst dhe Pulitzer, dekanët e gazetarisë amerikane, konkurruan me njëri-tjetrin për të parë kush do të mund të prodhonte historitë më sensacionale, të njëanshme, dhe lajme të njëanshme rreth krizës kubane²⁵.

Vetë Hearst më së miri e përshkroi këtë stil të gazetarisë kur ai duke fshikulluar Pulitzer duke deklaruar ishte një pseudo gazetar që i kishte bërë paratë e tij duke i lënë pas dore lajmet e vërteta dhe duke i zëvendësuar me shijet më të këqija të epshit dhe dashuri për horrorin, duke publikuar lajme false, dhe duke harruar përkushtimin për interesat e popullit. Ky lloj termi i gazetarisë u bë i njohur si Yelloë Journalism, që do të thoshte një stil që e bëri legjitimin përdorimin e metodave me çmim të ulët të bujshme dhe të paskrupullt në gazeta për të tërhequr ose për të ndikuar lexuesin. Sot, ajo cilësohet si "trash" ose tabloid journalism.

Metodologjia është pothuajse identike me atë të punësuar nga media amerikane në mbulimin e krizave e të Bosnjës dhe Kosovës.

E bëra këtë paraqitje pasi Kosova si një vend relativisht i ri është ende në forcimin e strukturave shtetërore dhe mënyrave që ato bashkëpunojnë me median. Duke qenë se dhe sot e kësaj dite të gjitha shkollat e gazetarisë marrin si përvojë dhe bazë për përgatitje atë të shkollës amerikane, atëherë është llogjike që do të biem pre e të njëjtave praktika. Kjo pjesë bëhet akoma më shumë më e rëndësishme pasi ndonëse në vendet e zhvilluara perëndimore është një praktikë e vendosur dhe ka shumë elementë që mundësojnë një zbatim të nocioneve bazë të ndryshimit mes Propagandës dhe PR-it, në vendet e brishta sic është Kosova ose edhe vëndet e tjera t ëish sistemeve diktatoriale këto elementë ose mungojnë ose janë të prishur deri diku dhe funksionojnë me gjysëm kapaciteti²⁶.

Kjo është arsyeja bazë të bëra këtë shkrim dhe këtë studim të shkurtër. Është interesante se ndonëse nocionet e gazetarisë janë të përfshira dhe bëhen në aspektin teorik kur vjen puna te zbatimi praktik ka shumë mangësi dhe në disa raste edhe injorancë. Sidoqoftë kjo është një shoqëri në zhvillim dhe shumë elemente ndryshojnë nga viti në vit por aktualisht ajo çfarë kam paraqitur më poshtë është realiteti actual i tanishëm në Kosovë.

Analiza, interpretimi i të dhënave

Sipas të dhënave të mbledhura 18% e publikimeve janë informata të drejtpërdrejta, 12% është informacion publicitar, 3% është PR, dhe 67% është propagandë. Të dhënat tregojnë se më shumë se gjysma e audiencës së targetuar është pre e propagandës dhe jo PR-it, ndonëse situata është e kontrolluar prapëseprapë më shumë ²⁷se gjysma e lajmeve politike të publikuara ka referenca të propagandës më shumë se ato të PR-it. Më duhet të specifikojë se kjo situatë ka të bëjë vetëm me lajmet politike, qofshin ato mediatike apo të shkruara, në pjesët e tjera të lajmeve si ato Ekonomike, Kulturore etj, ka më tepër elementë të PR-se sa të Propagandës.


Baskin & Aronoff (1992) . Marrëdhëniet me Publikun . WBC publikime Ristrukturimi dhe Procesi Urban - rajonal . Oxford dhe Cambridge , Mass .:Blackwell .

Baskin & Aronoff (1992) . Marrëdhëniet me Publikun . WBC publikime


Baskin & Aronoff (1992) . Marrëdhëniet me Publikun . WBC publikime

Baskin & Aronoff (1992) . Marrëdhëniet me Publikun . WBC publikime

usaid-tlp-sp.org/



Pjesa tjetër tregon se si kjo përqindje ndryshon në rastet kur i afrohen dhe largohen raportimit nga fushatat elektorale, qoftë vendore dhe qoftë ato nacionale²⁸. Më poshtë është krahasimi midis dy situatave përshkrua në përqindje. ²⁹Periodha që ka fushatë elektorale është marrë një vit, dhe është ndarë në tre periudha, periudha para fushatave elektorale ka 35% rritje në elementëve të Propagandës, gjatë fushatës elektorale pason vlera konstante me një rritje prej 33% dhe 28% pas fushatës elektorale. Nga ana tjetër në një vit që nuk ka fushate elektorale ka një rritje prej 4% gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit dhe prej 1% gjatë 6 mujorit të dytë.



Pjesa e më poshtme pasqyron ³⁰përqindjen dhe detajimin se sa prej gazetarëve të intervistuar ishin në gjendje të analizonin dhe ishin të vetëdijshëm për rastet kur ata kishin përdorur propagandën në vend të PR-it, sa përqind kishin përdorur PR-in në vend të propagandës në mënyrë të vetëdijshme dhe prej tyre nuk e kuptonin ndryshimin. Në bazë të të dhënave, 51 % nuk e kuptonin ndryshimin mes tyre, 34 % kishin përdorur propagandën në mënyrë të vetëdijshme, dhe 15% kishin ³¹përdorur PR-in në mënyrë të vetëdijshme. Besojmë se të dhënat e paraqitura më poshtë flasin vetë por do të donim të theksonim se mbi 70% e të anketuarve ishin mbi moshën 40 vjeçare.



Shoqëria . Oxford : Oxford University Press .
 usaid-tlp-sp.org/
 Gazeta e Sociologjisë . 51 (1) : 5-25
 usaid-tlp-sp.org/

Përfundimet

Siç është paraqitur nga datat e mësipërme është e kotë të pretendojmë se ndonjëse sistemet kanë ndryshuar dhe demokracia e liria ka triumfuar, mënyra e implementimit të tyre ende nuk ka filluar. Nga të dhënat e mësipërme shihet qartë se Propaganda është ende mënyra dominante e publikimit të lajmeve politike në Kosovë dhe do të mbetet ndoshta edhe për një kohë të gjatë. Kështu që e gjithë çka mbetet është të japim konkluzionet e mëposhtme:

Propaganda dhe PR ende keqkuptohet nga media kosovare.

Si e tillë ajo buron më së shumti nga një mungesë informacioni nga vetë përcuesit dhe përdoruesit e tyre, gazetarët.

Mungesa e një kulture politike ndikon në rritjen e drejtperdrejtë të mungesës së këtij informacioni.

Bibliografi

usaid-tlp-sp.org/

Baudrillard, J. (1990). *Hakmarrja e Chrystal*. Londër dhe Concord, MA: Plutoni Press p.88

Baskin & Aronoff (1992). *Marrëdhëniet me Publikun*. WBC publikime

Best, S. & D. Kellner (1991). *Teoria postmoderne: Kritik Intevrolations* (New York:Guilford Press)

Castells, M. (1989). *Informational Qyteti: Teknologjia e informacionit,*

Ekonomik Ristrukturimi dhe Procesi Urban - rajonal. Oxford dhe Cambridge, Mass

.: Blackwell.

Castells, M. (1996). *Ngritja e Shoqërisë Network*. Oxford dhe Malden, MA: Blackwell.

Castells, M. (1997). *Fuqia e Identitetit*. Oxford, dhe Malden, MA: Blackwell.

Castells, M. (1998). *Fundi i mijëvjeçarit*. Oxford, dhe Malden, MA: Blackwell.

Castells, M. (2000). *Materiale për një Teoria eksploruese të Shoqërisë Rrjetit*.

britanik Gazeta e Sociologjisë. 51 (1): 5-25

Castells, M. (2001a). *Galaxy Internet: Refleksione në internet, Biznes dhe Shoqëria*. Oxford: Oxford University Press.

Sztompka, P. (1996). *Looking back: the year 1989 as a cultural and civilizational break*. *Communist and Post-Communist Studies*, 29 (2), 115-129

Lauristin, M., Vihalemm, P., Rosengren, K.E., Weibull, L. (eds.) (1997), *Return to the Western World*. Cultural and Political

Perspectives on the Estonian PostCommunist transition, Estonia: Tartu University Press

RËNDËSIA E BURIMEVE NË JERËZORE PËR REALIZIMIN E STRATEGJISË SË FIRMËS

QEMAJL SEJDIJA

Universiteti Europian i Tiranës, Ekonomik, Menaxhment

ABSTRAKT

Burimet njerëzore sigurojnë avantazhe kompetitive për organizatën. Mjedisi me pasiguri në rritje, presioni në rritje për të kontrolluar kostot, dhe rregullimi qeveritar gjithnjë në rritje, kanë rritur rolin strategjik të menaxhmentit strategjik të burimeve njerëzore. Si rezultat, sot gjithnjë e më tepër po rritet involvimi i menaxhmentit të burimeve njerëzore në formulimin e strategjisë së përgjithshme të organizatës.

Menaxhmenti i burimeve njerëzore luan një rol me rëndësi për sigurimin e inputit paraprak në nivel të procesit të planifikimit strategjik të kompanisë. Tipologjia e aktiviteteve tregon se si aktivitetet e burimeve njerëzore ndryshojnë sa i përket kontributit të tyre implementimit të strategjisë.

Strategjia e burimeve njerëzore fokusohet në ndërtimin dhe zhvillimin e praktikave, politikave, dhe programeve në planet në nivel të kompanisë dhe njësive strategjike të biznesit brenda saj

Planifikimi i burimeve njerëzore siguron një ndërlidhje tjetër shumë me rëndësi me strategjinë organizative duke siguruar një input për disponueshmërinë e fuqisë punëtore me rëndësi kryesore për implementimin e strategjisë së përgjithshme kompetitive të kompanisë, dhe duke themeluar një ekip drejtues që merret me menaxhimin e mungesave / tepricave të fuqisë punëtore në periudha të caktuara kohore.

Pavarësisht nga zhvillimet bashkëkohore, në shumë kompani, edhe më tutje ekziston nevoja e integritit më të fuqishëm të planifikimit të burimeve njerëzore me procesin e formulimit të strategjisë organizative.

Faktorët që influencojnë nivelin e integritit inkludojnë dallimet ndërmjet industrive, lëkundjet në aktivitetin ekonomik, ndryshimet e vazhduara të teknologjisë, dhe ndryshimet e vazhduara demografike. Ne kemi paraqitur në këtë punim disa raste të integritit, duke shpjeguar edhe pengesat që kishin kufizuar integritet e tilla.

Fjalë kyçe: *burimet njerëzore, performancë, planifikimi strategjik, integriti i strategjisë, menax*

1. Hyrje

Menaxhmenti i burimeve njerëzore është bërë me rëndësi më të madhe për menaxhmentin e përgjithshëm, kryesisht si rezultat i rolit të tij për sigurimin e avantazhit kompetitiv, përmes rekrutimit të personelit me cilësi konkurruese, dhe parashikimit të kërkesave për burime njerëzore në mjediset e avancuara teknologjike në të ardhshmen.

Strategjist i njohur Michael Porter kishte gjetur se menaxhmenti i burimeve njerëzore përbën faktorin kryesor për sigurimin e avantazhit konkurrues.¹ Shi për këtë, një numër gjithënjë në rritje i organizatave po implementojnë menaxhment strategjik të burimeve njerëzore për realizimin e avantazheve konkurruese. Tani është bërë e njohur dhe e pranuar nga të gjithë hulumtuesit shkencor, ekspertet dhe profesionistët në fushën e menaxhmentit strategjik, se kompetencat cilësore dhe dalluese sigurohen përmes shkathësive të zhvilluara në shkallë të lartë, kulturës organizative, proceseve dhe sistemeve menaxhuese. Kjo në fakt i kundërvihet theksimit tradicional për burimet e transferueshme, siç janë pajisjet të cilat mund të blihen nga konkurrenca. Tani më është fakt i pranuar se avantazhet konkurruese sigurohen përmes fuqisë punëtore me cilësi të lartë, e cila bënë të mundur që organizatat të konkurrojnë me produkte dhe shërbime cilësore, me risime teknologjike, në vend që të mbështeten vetëm në uljen e kostove.

Një shembull i mirë që ilustron avantazhet konkurruese të menaxhmentit të burimeve njerëzore është prezantuar nga përpjekjet e kompanisë John Deere për automatizimin e fabrikave. Si rezultat i zhvillimit të talentit të veçantë dhe ekspertizës në automatizimin e fabrikave, kompania kishte themeluar një sektor të veçantë për teknologji.² Një shembull tjetër është kompania ARCO e cila kishte vënë theksin në çështjet e menaxhmentit të burimeve njerëzore brënda programit të zhvillimit të përgjithshëm.³

Shembujt si këta, tregojnë për përgjegjësitë dhe rëndësinë e menaxhmentit strategjik të burimeve njerëzore. Përveç rolit për sigurimin e avantazheve konkurruese përmes fuqisë punëtore të kualifikuar dhe cilësore, menaxhmenti strategjik i burimeve njerëzore është përqendruar dhe ka çuar përpara edhe rolin e kontrollit të kostove të punës. Si rezultat i presionit të madh mbi kontrollin e kostove, menaxheret ekzekutiv janë fokusuar në shfrytëzimin efikas të burimeve njerëzore, që reflekton drejtpërdrejt në realizimin e strategjisë së përgjithshme të kompanisë. Menaxherët duhet të mbikëqyrin dhe të kontrollojnë ata punëtor të cilët nuk shfrytëzohen në pajtim me shkathësitë dhe aftësitë që zotërojnë, të ndikojnë që mungesa e besimit reciprok të shëndërrohet në bashkëpunim, që rezistenca kundrejt ndryshimeve të shëndërrohet në kërkesa për ndryshime të vazhdueshme, të ndikojnë në zvogëlimin deri në eliminim të antagonizmave ndërmjet punëtorëve dhe menaxhmentit, të zgjidhin problemet e motivimit, dhe të eliminojnë praktikatat punuese që shkaktojnë zvogëlimin e produktivitetit.

Është provuar se, burimet e alokuara drejt shfrytëzimit më të madh të burimeve njerëzore janë me eficiencë më të lartë kundrejt investimeve në impiante dhe pajisje. Për arsye të eficiencës së mundshme në kosto, menaxhmenti i përmirësuar i burimeve njerëzore do mund të luaj një rol kyç në strategjinë kompetitive të organizatës dhe në zhvillimin e kompetencave të veçanta dalluese.

Turbulencat ekonomike poashtu kanë ndikuar në rritjen e rolit strategjik të menaxhmentit të burimeve njerëzore. Turbulenca, globalizimi, teknologjia, demografia me ndryshime dramatike, dhe diferencat në vlerat e fuqisë punëtore kanë krijuar një mjedis të pasigurt dhe me shumë kërcënime për organizatën. Menaxhmenti strategjik i burimeve njerëzore dhe procesi i planifikimit të burimeve njerëzore që zhvillohet brënda këtij menaxhmenti gjithnjë e më tepër po shikohen si mjete dhe metoda për amortizimin e pasigurisë në mjedisin biznesor. Dhe kjo ka ndikuar që menaxhmenti i burimeve njerëzore të integrohet në formulimin e strategjisë dhe në procesin e planifikimit të integral në organizatë.

Aq sa menaxhmenti i burimeve njerëzore po bëhet një komponent me rëndësi më të madhe për strategjinë kompetitive të kompanisë, menaxhmenti ekzekutiv është nxitur të sigurojë bashkërendimin konsistent midis strategjisë dhe politikave dhe praktikave të burimeve njerëzore. Sfidat e parë në procesin e kësaj bashkërenditje shtrihen si nevojë për gjetjen e përgjigjës në pyetjen se: “Çfarë llojë burimesh njerëzore, në sasi dhe cilësi, do të duhen për drejtimin e organizatës në vitet e ardhshme?” Kjo mbështetet në pritshmëritë e organizatës, se siguri i burimeve njerëzore kompatible me strategjinë dhe kërkesat e ardhshme të organizatës, do sigurojë një performancë organizative superiore. Edhe pse evidenca mbi këtë problematikë është e përzier, disa studime empirike të kohëve më të reja kanë gjetur se performanca më e lartë i referohet dhe është e lidhur ngusht me menaxhmentin strategjik të burimeve njerëzore të integruar në strategjinë e përgjithshme zhvillimore të kompanisë.

2. Bazat teorike

2.1. Koncepte dhe përkufizime strategjike

Termi menaxhmenti strategjik i burimeve njerëzore ka filluar të përdoret me të madhe në literaturën për menaxhmentin. Në përgjithësi, qëllimi themelor i menaxhmentit strategjik të burimeve njerëzore është të implementojë ato politika dhe praktika të burimeve njerëzore të cilat do të përmbushin kërkesat dhe objektivat strategjike të organizatës. Gjatë përcaktimit të termit, ekspertët dhe profesionistët nga praktika kujdesen që të theksojnë rolin e implementimit të menaxhmentit strategjik

Porter, Michael E. Competitive Advantage: Creating and Sustaining Superior Performance. Page 281 STRATEGIC HUMAN RESOURCE MANAGEMENT Section Two.

Dyer, Lee. “Bringing Human Resources into the Strategy Formulation Process,” Human Resource Management 22, no. 3 (1983): 257–71.

ARCO. ARCO Annual Report, 1986.

të burimeve njerëzore, në mënyrën e përcaktuar sipas përkufizimit: Implementimi efektiv i strategjisë së biznesit . . . duke bërë që secili anëtar i burimeve njerëzore, nga pozitën më të lartë e deri te ato të shkallës më të ulët, të kryejnë ato detyra që ndihmojnë suksesin e biznesit.”

Një përkufizim akademik më gjithëpërfshirës i menaxhmentit strategjik të burimeve njerëzore saktëson në mënyrë të qartë se: Menaxhmenti strategjik i burimeve njerëzore ka të bëjë kryesisht me integrimin dhe adaptimin. Ai kryesisht duhet të sigurojë që:

- Menaxhmenti i burimeve njerëzore (MBNJ) është integruar tërësisht në strategjinë zhvillimore të kompanisë dhe me kërkesat strategjike të saj;
- Politikat e MBNJ ndërlidhen me politikat zhvillimore dhe me hierarkinë e prioritetëve dhe primatit; dhe
- Praktikat e MBNJ rregullohen, pranohen, dhe përdoren nga menaxherët dhe puntorët, si pjesë e punës së tyre të përditshme.

Autorët Patrick Wright dhe Gary McMahan kishin bërë një përkufizim të ngjashëm për menaxhmentin strategjik të burimeve njerëzore⁴. Në përkufizimin e tyre ata theksojnë se menaxhmenti strategjik i burimeve njerëzore është “një sistem i zhvillimit dhe shpërndarjes së burimeve njerëzore dhe aktiviteteve në atë mënyrë që të realizohen qëllimet kryesore të organizatës.”

Duke marrë parasysh këto përkufizime për menaxhmentin strategjik të burimeve njerëzore, mund të përcaktohet një kornizë teorike e cila mund të përdoret për organizimin e njëjësive se si praktikatat e burimeve njerëzore janë ndikuar nga konsideratat strategjike. Një kornizë e tillë teorike ishte zhvilluar nga autorët Patrick Wright dhe Gary McMahan. Kjo kornizë paraqet faktorë teorik, katër nga të cilët japin sqarime për konsideratat strategjike të përfshirjes së burimeve njerëzore në strategjinë zhvillimore të biznesit. Faktori i parë, që mbështetet në këndvështrimin e burimeve, shpjegon praktikatat që sigurojnë avantazhe kompetitive, siç janë alokimi unik i burimeve të firmës, kultura organizative, dhe kompetencat e veçanta dalluese. Për shembull, firma mund të alokojë burimet e saj duke përdorur procedura superiore të përzgjedhjes dhe sisteme të avancuara të kompenzimit, në mënyrë që të sigurojë kompetenca të veçanta dalluese. Faktori i dytë, që mbështetet në sjelljen organizative, dhe bazohet në teorinë e probabilitetit, shpjegon praktikatat e dizajnuara për kontroll dhe ndikim në qëndrimin ndaj detyrave. Kjo trajton aspektin instrumental të praktikave të tilla në procesin e realizimit të objektivave strategjike. Faktori i tretë bazohet në sistemet kibernetike. Nga ky këndvështrim shpjegon adoptimin apo braktisjen e praktikave që rezultojnë nga feedback-u i kontributit të MBNJ në realizimin e strategjisë së përgjithshme të kompanisë. Shikuar nga ky këndvështrim, mund të miratohen programet e trajnimit që do ndihmojnë organizatën të realizojë strategjinë e saj, mbi bazë të feedback-ut. Faktori i katërt, bazohet në kostot sipas njësive që i shkaktojnë ato, shpjegon pse kompanitë përdorin sisteme kontrolli, siç janë vlerësimi i performancës dhe sistemi i shpërblimeve. Në mungesë të vlerësimit të performancës dhe ndërlidhjes me sistemin e shpërblimeve, nuk do mund të ndjeken strategjitë e përgjithshme të firmës nga MBNJ. Faktori final, që bazohet në teorinë institucionale, shpjegon pse praktikatat, siç janë përdorimi i dimensionit jo të përshtatshëm të vlerësimit të performancës, mund të ekzistojnë nga organizimi joadekuat dhe jo nga vendimmarrja e arsyeshme.

2.2. Strategjia

Literatura bashkëkohore ofron një numër të tërë të përkufizimeve për menaxhmentin strategjik. Përkufizimi i James Brian Quinn i strategjisë fokusohet në integrimin e qëllimeve, politikave, dhe veprimeve: “Strategjia është një kornizë apo plan që integron qëllimet kryesore të një organizate, politikave dhe veprimet e saj në një tërësi të vetme dhe të qëndrueshme.”⁶ Kështu, strategjia merret me sigurimin e drejtimit të zhvillimit, duke koordinuar dhe siguruar një kornizë të vendim marrjes. Strategjia poashtu merret me alokimin e burimeve. Përkufizimi në vijim që kishte dhënë William Henn fokusohet në këtë aspekt të strategjisë: “Strategjia është përqëndrimi i burimeve në mundësitë e përzgjedhura që sigurojnë avantazhe kompetitive.”⁷ Eksperti i strategjisë Kenichi Ohmae kishte theksuar elementet të ngjashme për strategjinë, “Vetëm alokimi i burimeve në mënyrë të njëjtë me konkurrentët nuk do sigurojë avantazhe kompetitive për firmën.”⁸

Përkufizimet që japin për strategjinë William Henn dhe Ohmae fokusohen në bërjen e vendimeve për alokimin e burimeve nga linjat e prodhimit që nuk sigurojnë sasi dhe cilësi të mjaftueshme të produkteve dhe shërbimeve, dhe përqëndrimin e tyre në linjat e prodhimit që sigurojnë produkte dhe shërbime me sasi dhe cilësi të kënaqshme, dhe sigurojnë avantazhe kompetitive.

Kur dështojmë të përzgjedhim mundësitë premtuese, dhe marrim vendime për alokimin e burimeve, zakonisht burimet shpërndahen në mënyrë të barabartë nëpër linjat e prodhimit, duke humbur kështu mundësitë për realizimin e avantazheve kompetitive. Prandaj themi se strategjia kryen funksionin e drejtimit, koordinimit, bërjes së vendimeve, dhe alokimit të burimeve.

Wright, Patrick M., and Gary C. McMahan. “Theoretical Perspectives for Strategic Human Resource Management,” *Journal of Management* 18, no. 2 (1992): 295–320.

Ibid., p. 298.

Quinn, James B. *Strategies for Change: Logical Incrementalism*. Homewood, IL: Richard D. Irwin, 1980, p. 7.

Henn, William R. “What the Strategist Asks from Human Resources,” *Human Resource Planning* 8, no. 4 (1985): 195 (whole article on pp. 193–200).

⁸ Ohmae, Kenichi. *The Mind of the Strategist*. New York: Penguin Books, 1988, p. 42.

2.3. Planifikimi Strategjik

Përkufizimet për planifikimin strategjik, që quhet edhe proces i formulimit të strategjisë,⁹ dallojnë sa i përket theksimit të arsyeshmërisë dhe formalitetit. Autori James Craft jep këtë përshkrim të planifikimit strategjik të arsyeshëm dhe gjithëpërfshirës: Një proces i arsyeshëm dhe gjithëpërfshirës, që nga shumë praktikient quhet një aktivitet i vetëdijshëm për formulimin e qëllimeve, ekzaminimin e alternativave, dhe përkshkrim i planeve për veprimet e ardhshme¹⁰. Planifikimi strategjik synon të ketë orientim afatgjatë dhe fokusohet në faktorë të matshëm që ndikojnë në performancë, si dhe në aktivitete dhe procedura kuantitative. Procesi i planifikimit strategjik formal të arsyeshëm dhe gjithëpërfshirës është i kompozuar nga hapat si në vijim:

- Zhvillimi i filozofisë organizative dhe formulimi i misionit
- Skanojografia e mjedisit
- Analiza e përparësive dhe dobësive, mundësive, dhe kërcënimeve (analiza SWOT)
- Formulimi i objektivave strategjike
- Gjenerimi i strategjive alternative për realizimin e objektivave
- Evalrimi dhe përzgjedhja e strategjive.

Në këtë varg të hapave nuk përmenden aspektet politike të planifikimit strategjik.

Megjithatë, formaliteti i procesit dhe theksimi i procesve logjike dhe kuantitative nuk duhet të fsheh faktin se planifikimi strategjik zakonisht performohet dhe realizohet përmes koalicioneve me ndikim. Për shkak të natyrës politike të procesit, disa aspekte të planit duhet të negocohen. E kundërta e planifikimit strategjik formal dhe gjithëpërfshirës, është planifikimi strategjik joformal dhe jo gjithëpërfshirës, që fokusohet në natyrën e përkohshme dhe emergjente të strategjisë, dhe është me afatë të shkurtër.

Sipas Quinn, qasja joformale dhe jo gjithëpërfshirëse paraqet një proces të përshtatjes, duke bërë ndryshime dhe rregullime në strategjinë e kompanisë, mbi bazë të informacionit nga feedback-u.¹¹ Këtu duhet theksuar se planifikimi strategjik joformal dhe jo gjithëpërfshirës nuk është jokonsistent me planifikimin formal, por ndihmon në implementimin e shpejtë të strategjisë duke shmangur gabimet me pasoja negative që mund të ndikojnë në mosrealizimin e strategjisë së përgjithshme zhvillimore të kompanisë.

Edhe pse këto dy tipe të planifikimit strategjik dallojnë mes vete, përdorimi i tyre i përbashkët nuk është përjashtues, dhe kompanitë zakonisht i aplikojnë të dyja këto qasje. Prandaj edhe është më e dobishme të mendojmë për planifikimin strategjik si një proces të balancuar i planifikimit strategjik formal dhe gjithëpërfshirës, dhe planifikimit joformal dhe jo gjithëpërfshirës, që zbatohen varësisht nga kërkesat në kohën e caktuar dhe në mjedisin e caktuar.

Duke lënë anash shkallën e formalitetit apo joformalitetit, planifikimi strategjik kryen një varg funksionesh me rëndësi kruciale, siç janë

- Skanojografia e kohë pas kohshme e të ardhmës
- Analiza e bazuar në intervale të gjata kohore
- Komunikimi për qëllimet dhe alokimin e burimeve
- Korniza për planifikim afat shkurtër, vlerësimin dhe integrimin e tij
- Institucionalizimi i periudhave afat gjata, të domosdoshme për investime, siç janë kërkimet dhe zhvillimi
- Korniza për vendim bërje në afat të shkurtër.

2.4. Strategjia kompetitive në njësitë e biznesit

Në diskutimet e mësipërme mbi planifikimin strategjik ne u fokusuam në planifikimin në nivel korporate. Megjithatë, strategjitë kompetitive në nivel të biznesit janë me rëndësi për burimet njerëzore dhe për zhvillimin e strategjive të menaxhmentit të burimeve njerëzore. Korniza që paraqet Michael Porter¹² siguron një bazë të mirë për kuptimin e strategjive kompetitive në nivel të biznesit. Porter kishte provuar se ekzistojnë pesë faktor që ndikojnë në fitimet e një industrie: Ata faktorë, të cilët mbështetn kryesisht në arsyen ekonomike të ekonomistit Alfred Marshall, inkludojnë lehtësitë me të cilat kompetitorët mund të hyjnë në një industri, fuqinë blerëse të klientëve, fuqinë konkurruese të furnitorëve, fuqinë e firmave konkurrenente brënda industrisë së caktuar, dhe mundësinë e përdorimit të surrogatëve për mallrat dhe shërbimet e industrisë konkrete. Në fakt, ekzistojnë disa karakteristika specifike me të cilat mund të vlerësohen ata faktorë. Për shembull, pengesat për depërtim në një industri influencohen nga ndikimet siç janë ekonomia e shkallës, kosto e kapitalit, dhe rregullmi qeveritar. Këta faktorë sigurojnë bazën për zhvillimin e një mekanizmi për vlerësim që e quajmë vlera zinxhir, që tregon se si firmat vlerësojnë aftësitë e tyre për konkurrim dhe marrin vendime në lidhje me strategjinë e tyre kompetitive. Shembujtë e aktiviteteve parësore në

Higgins, James M., and Julian W. Vincze. Strategic Management: Text and Cases. Chicago: Dryden Press, 1989.

Craft, James A. "Human Resource Planning and Strategy," in Lee Dyer (Ed.), Human Resource Management: Evolving Roles and Responsibilities. Washington, DC: Bureau of National Affairs, 1988, p. 53.

Quinn, James B. "Retrospective Commentary," Sloan Management Review 30, no. 4 (1989): 55–60.

Porter, Michael E. Competitive Advantage: Creating and Sustaining Superior Performance.

zinxhirin e vlerës përfshijnë veprimet, logjistikën, dhe shërbimet, ndërsa shembujtë e aktiviteteve mbështetëse përfshijnë burimet njerëzore dhe teknologjinë. Kuptimi i kombinuar i atraktivitetit të një industrie dhe vetëdijës së një industrie për aftësitë e saj konkurruese, i mundësojnë firmës të zgjedh një strategji për të konkurruar brënda industrisë. Në fakt, ekzistojnë tri strategji gjenerike për konkurrim brënda një industrie: lidhshipi me kosto të ulët, diferencimi (produktet apo shërbimet e dallueshme), dhe kombinimet që fokusohen në variacionet që aplikojnë lidhshipi me kosto të ulët dhe diferencim në produkte dhe shërbime në segmentin e caktuar të industrisë. Strategjitë e tilla kompetitive të biznesit janë me rëndësi për formulimin e strategjisë së menaxhmentit të burimeve njerëzore, sepse praktika të caktuara të burimeve njerëzore janë konsistente me strategjitë e caktuara kompetitive. Autorët Raymond Miles dhe Charles Snow kishin paraqitur një model të strategjisë së biznesit që tregon se si firmat përshtaten për të përmbushur më mirë kërkesat e caktuara me mjedisin e tyre kompetitiv.¹³

2.5. Planifikimi në njësitë strategjike të biznesit

Menaxhmenti i burimeve njerëzore mund të luaj një rol me rëndësi në planifikimin strategjik në nivel të njësive strategjike të biznesit. Ky rol mund të ekzaminohet në kontekst të inputit të burimeve njerëzore në zhvillimin e alternativave strategjike. Për shembull, grupi për marketing në njësinë strategjike të biznesit mund të identifikon një mundësi gjatë procesit të planifikimit. Atëherë planerët e marketingut zhvillojnë strategji të ndryshme për realizimin e efekteve optimale. Si pjesë e procesit të planifikimit, përfaqësuesit nga fushat funksionale siç janë prodhimi, financa, dhe burimet njerëzore, supozojnë inpute të ndryshme për alternativa të ndryshme, duke marr parasysh përparësitë, mangësitë dhe kërkesat për secilin variant veç e veç. Menaxhmenti i burimeve njerëzore do duhej të sigurojë një analizë për implikimet për burimet njerëzore për secilën alternativë strategjike veç e veç. Produkti i këtyre proceseve të planifikimit më pas i dërgohet për shqyrtim menaxhmentit ekzekutiv të korporatës për miratim dhe financim.

Në disa korporata, nënpresidenti për burime njerëzore është edhe anëtar i komitetit ekzekutiv për miratimin e vendimeve finale për propozimet e ndryshme të alternativave strategjike. Ky përfaqësim i burimeve njerëzore nga nënpresidenti për burime njerëzore përbën edhe një rol të ri të burimeve njerëzore për strategjinë kompetitive të firmës.

2.6. Strategjia e burimeve njerëzore

Në diskutimet tona ne kemi trajtuar konceptet e përgjithshme të strategjisë dhe planifikimit strategjik në nivel të korporatës, dhe në nivel të njësive strategjike të biznesit. Tani do të përqendrohemi në strategjinë e burimeve njerëzore, që është përkufizuar nga Randall Schuler si në vijim: “Strategjitë e MBNJ janë në fakt planet dhe programet që adresojnë dhe zgjidhin çështjet strategjike fundamentale në lidhje me menaxhmentin e burimeve njerëzore.”¹⁴ Strategjia e burimeve njerëzore fokusohet në ndërtimin dhe zhvillimin e praktikave, politikave, dhe programeve në planet në nivel të kompanisë dhe njësive strategjike të biznesit brënda saj.

Politikat dhe praktikat konsistente brënda menaxhmentit të burimeve njerëzore janë me rëndësi kryesore për menaxhmentin e përgjithshëm të kompanisë si dhe për funksionin e burimeve njerëzore.¹⁵ Diferencat në politikat dhe praktikat e menaxhmentit të burimeve njerëzore sipas industrive tregojnë se politikat dhe praktikat e personelit dallojnë varësisht nga mjedisi në të cilin veprojnë kompanitë e ndryshme. Mirëpo, kategoritë industriale nuk shpjegojnë të gjitha ato dallime sepse dallimet në strategjitë e kompanive ndikojnë edhe në politikat dhe praktikat e burimeve njerëzore. Kompanitë në përgjithësi provojnë të shmangin theksimin e harmonizimit të politikave dhe praktikave të burimeve njerëzore me strategjitë e tyre. Kjo sepse, harmonizimi i plotë ndërmjet këtyre dy kategorive zakonisht kërkon kohë të caktuar për rekrutim dhe trajnim të personelit. Poashtu, përshtatja e plotë e burimeve njerëzore me strategjinë e kompanisë do të ndikonte edhe në kufizimin e zhvillimit të shkathësive të punëtorëve, t’ i pengojë ata për zhvillimin e risimeve, dhe të kufizojë mundësitë për ndryshim.

Një aspekt tjetër kritik i formulimit të strategjisë është edhe strategjia ndërkombëtare e burimeve njerëzore. Përveç vendimeve nëse duhet ndjekur strategjitë e shoqërive shumëkombëshe apo strategjitë globale, kompanitë duhet të zgjidhin problemin e burimeve njerëzore në mënyrë që mos t’i zhvleftësojnë shkathësitë e burimeve njerëzore me rastin e ndonjë aleance ndërkombëtare (bashkim apo shkrirje). Kështu për shembull, në të kaluarën shumë kompani të SHBA nuk kishin mësuar shpejt sa ishte dashur, sikur disa partner nga aleancat ndërkombëtare, dhe për këtë kishin paguar çmimin në kuptimin e dobësimit të pozicionit të tyre brënda aleancave ndërkombëtare.

2.7. Planifikimi i burimeve njerëzore

Planifikimi i burimeve njerëzore siguron inputin për proceset e planifikimit strategjik në nivel më të lartë. Një dobi nga planifikimi i tillë është ai se, pa marr parasysh saktësinë e parashikimeve të përfshira me planifikim, vet akti i zhvillimit të parashikimeve i detyron menaxherët të rivlerësojnë syzozimet themelore mbi të cilat vepron organizata. Kontribute të tjera të planifikimit të burimeve njerëzore janë se: Ai sinjalizon nevojën për ndryshime dhe shërben si udhërrëfyes për aktivitetet brënda menaxhmentit të burimeve njerëzore drejt kompatibilitetit në shkallë më të lartë me organizatën.

Miles and Snow. “Designing Strategic Human Resources Systems”; Sonnenfeld and Peiperl. “Staffing Policy as a Strategic Response.” Schuler. “Strategic Human Resources Management: Linking the People with the Strategic Needs of the Business,” p. 24. Craft. “Human Resource Planning and Strategy”; Beer, Spector, Lawrence, Mills, and Walton. Managing Human Assets.

Procesi i planifikimit të burimeve njerëzore, përfshinë brënda vetes skanografinë e mjedisit në të cilin vepron organizata dhe ndërveprimin me planifikimin strategjik, parashikimin e kërkesës për burime njerëzore, inventarizimin e rezervave aktuale të burimeve njerëzore të organizatës, duke parashikuar mundësinë e sigurimit të fuqisë punëtore nga brënda dhe jashtë organizata, duke krahasuar kërkesën dhe ofertën e parashikuar, duke zhvilluar plane për zgjidhjen e problemeve në lidhje me mungesën e fuqisë punëtore apo me tepricën e fuqisë punëtore, dhe duke involvuar të gjitha këto rezultate në planifikimin strategjik të organizatës.

3. Kontributi i burimeve njerëzore për strategjinë e organizatës

3.1. Vështrim hyrës

Burimet njerëzore mund t'i kontribuojnë strategjisë dhe planifikimit strategjik të organizatës në shumë mënyra. Sistemet siç janë vlerësimi i performancës, vlerësimi i personelit, trajnimi, dhe kompensimi, u mundësojnë menaxherëve të implementojnë planin strategjik të organizatës. Planifikimi i burimeve njerëzore, poashtu, lidh menaxhmentin strategjik dhe planifikimin e biznesit me ato sisteme. Modelet e shumta të menaxhmentit të burimeve njerëzore vështrojnë këtë funksion si funksion që ka rol implementues, dhe është e rrallë mundësia e gjetjes së kompanive që përdorin kapacitete të njëjta të burimeve njerëzore si input parësor në procesin e formulimit të strategjisë.

Por tani më është fakt i pranuar se, shumë kompani po mbështeten në menaxhmentin e burimeve njerëzore gjatë procesit të formulimit të strategjisë së organizatës. Situatat në të cilat kapacitetet e burimeve njerëzore shërbejnë si forcë shtytëse në procesin e formulimit të strategjisë ndodhin kur ekzistojnë kapacitete unike, siç përmendëm më sipër me shembullin e kompanisë John Deere, e cila kishte themeluar sektorin e teknologjisë. Një shembull tjetër që ilustron këtë është ai i kompanisë Arthur Andersen, që kishte kapacitete trajnuese unike të burimeve njerëzore. Kompania për shërbime të kontabilitetit Saint Charles, Illinois, ofron shërbime që sigurojnë avantazhe kompetitive. Me mijëra punonjës të kompanisë Arthur Andersen marrin trajnime nga ekipi brënda firmës me kualifikime dhe kompetenca të shkallës së lartë për çdo vit. Për këtë arsye firma mund të reagojë shpejtë në kërkesat e ndryshuara të klientëve të saj. Poashtu, kostot e burimeve njerëzore kan implikime për strategjinë e organizatës dhe përfshihen në strategjinë e përgjithshme. Kjo nuk ishte e shpesht në të kaluarën, derisa ato kosto nuk kishin arritur vlera ekstreme.

3.2. Skanografia e mjedisit dhe inteligjenca kompetitive

Menaxhmenti i burimeve njerëzore luan rolin e skanografimit të mjedisit në mënyrë të njëjtë siç veprojnë edhe funksionet e financës dhe marketingut. Aktivitetet e skanografisë janë me rëndësi të veçantë në periudhat e ndryshimeve rapide të teknologjive dhe mjedisit dinamik të tregut. Zakonisht, përpjekjet e tilla fokusohen në trende në periudha tre deri pesë vjetë thell në të ardhmën dhe mbulojnë zhvillimet në demografi, teknologji, çështje sociale, ekonomiks, dhe mjedisin rregullator. Një shembull i trendëve me interes për skanografinë e burimeve njerëzore mund të jetë reagimi i konkurrencës në situata të caktuara kur kompania synon depërtimin në tregje të reja.

Një mënyrë tjetër mjaft interesante, përmes së cilës funksioni i menaxhmentit të burimeve njerëzore mund të jep kontribute shtesë, është në fushën e inteligjencës kompetitive, nga se funksioni i MBNJ mund të jetë një burim me rëndësi i informacionit të tillë. Për shembull, me që menaxherët e burimeve njerëzore pranojnë aplikacione të punonjësve nga firmat e tjera konkurrense brënda industrisë, ata e dijnë se kush po lëviz. Ata gjithashtu dijnë shkathësitë dhe kompetencat të cilat kërkojnë firmat konkurrense gjatë rekrutimit të personelit. Duke analizuar tipet e individëve që aplikojnë për punë dhe trendët në aplikimin e tyre, menaxherët mund të nxjerrin informacion që mund të ndihmojë për të identifikuar drejtimin të cilin po ndjekin firmat konkurrense. Në mënyrë më specifike, burimet njerëzore mund të sigurojnë informacion për inteligjencën e kompanisë si në vijim: Nga informacioni publik dhe aktivitetet e rekrutimit dhe intervistimit, mund të ndërtohet struktura organizative, niveli i personelit dhe misioni i formuluar për komponentët e ndryshëm organizativ të secilës firm konkurrense. Njohuritë se si janë organizuar funksionet dhe se kush kujt i raporton, japin informacion të mjaftueshëm për prioritetet strategjike të firmave konkurrense. Madje mund të sigurojmë edhe informacion të bollshëm për karakteristikat dhe sjelljet e caktuara të menaxherëve ekzekutiv të firmave konkurrense.

Pa marr parasysh formën e lidhjes ndërmjet menaxhmentit të burimeve njerëzore dhe procesit të planifikimit strategjik, menaxherët e burimeve njerëzore duhet të parashikojnë llojin e kualifikimit dhe kompetencave të individëve që duhet të punësohen me qëllim të mbështetjes së strategjisë së organizatës në të ardhmën.

3.3. Implementimi i vendimeve për rialokimin e burimeve

Roli kryesor i menaxhmentit të burimeve njerëzore është të vlerësojë mundësitë për implementimin e strategjisë dhe të sigurojë atë input në procesin formulimit të strategjisë. Me që esenca e strategjisë është të përqendroj burimet ashtu që organizata të sigurojë avantazhe kompetitive në treg, kjo nënkupton se disa njësi, sektoreve, apo linjave të prodhimit duhet t'u ndërpriten burimet. Si rezultat i ndërprerjes së burimeve, menaxhmenti i burimeve njerëzore duhet të parandalojë demoralizimin e atyre që nuk do ju shpërndahen burime. Shpesh, fushat të cilave nuk ju shpërndahen burime janë edhe më tutje me rëndësi të

madhe për organizatën, së paku në afat të shkurtër, për suksesin dhe prosperitetin e kompanisë. Për shembull, ato fusha të biznesit në të cilat ekzistojnë mundësi dhe në të cilat kompania mbështet fuqinë e saj do u shpërndahen burime në sasi më të madhe. Ato burime do të vijnë nga fushat në të cilat pritet të bie kërkesa për industritë e tyre në të ardhmën, por në të cilat aktualisht kompania mbështet fuqinë e saj dhe krijon profite. Burimet gjithashtu do të vijnë nga ato fusha që karakterizohen si industri jo atraktive dhe dhe që nuk përfaqësojnë fuqinë e kompanisë. Me që ato fusha nuk do përfitojnë nga shpërndarja e burimeve, është me rëndësi kryesore mënyra e trajtimit të punonjësve nga ato fusha. Madje me rëndësi kryesore edhe për realizimin e strategjisë së kompanisë në përgjithësi. Për shembull, ata që do përballen me shkurtime burimesh a do të lejohen të transferohen në njësi të tjera brënda kompanisë apo do ju lejohet të kalojnë në kompani të tjera. Pra, çështja është nëse kompania guxon të lejojë që ata të trajtohen jo në mënyrë adekuate në kontekstin e strategjisë së përgjithshme të kompanisë.

3.4. Drejtimi i ekipit për zgjidhjen e problemeve në lidhje me mungesat / tepricat e fuqisë punëtore

Një kontribut tjetër i menaxhmentit të burimeve njerëzore vije nga ekipi drejtues që merret me zgjidhjen e problemeve në lidhje me mungesat / tepricat e fuqisë punëtore, që krijohen përmes planifikimit të burimeve njerëzore. Ky ekip siguron alternativat për zgjidhjen e problemeve me mungesat apo tepricat e fuqisë punëtore. Poashtu, në qoftë se kompania ka përdor mundësin e punësimeve sezonale apo emergjente në strategjinë e punësimit, punonjësit e tillë sigurojnë një mekanizëm për manovrim strategjik, sepse ky lloj i punonjësve mund të trajtohet/konsiderohet shpesh si kosto variabile. Për rezultat, punëdhënësit kanë shkallë më të lartë të lirisë dhe fleksibilitetit për të ushtruar opsione të ndryshme. Fatkeqësisht, menaxhmenti i burimeve njerëzore edhe më tutje nuk ka rol strategjik në shumë organizata dhe, për rezultat, një ekip i tillë për zgjidhjen e problemeve të mungesave/tepricave të fuqisë punëtore as nuk ekziston në shumë organizata.

4. Integrimi i strategjisë dhe planifikimit të burimeve njerëzore

4.1. Vështrim hyrës

Integrimi i strategjisë së biznesit dhe strategjisë dhe planifikimit të burimeve njerëzore është me rëndësi të madhe për planifikimin afat gjatë të burimeve njerëzore në kompani. Për më tepër, me vlerësimin e e kontributit potencial të planifikimit të burimeve njerëzore, menaxherët e linjave kanë marr mbi vete përgjegjësi të mëdha për planifikimin e nevojave për burime njerëzore. Kujtojmë se arsyeja pse duhet të ketë integrim më të madhë midis strategjisë së biznesit dhe strategjisë dhe planifikimit të burimeve njerëzore më së miri e përshkruan konstatimi në vijim: Me që është pranuar përgjithësisht se fuqia punëtore e një organizate nuk mund të ndryshojë krejtësisht brënda një kohe të shkurtër, planifikimi afat gjatë i burimeve njerëzore po pranohet si objektiv real gjithnjë e më tepër. Ky është një aktivitet që kërkon integrimin e shkathësive dhe të njohurive të planerëve të burimeve njerëzore dhe të të gjithë menaxherëve ekzekutiv përgjegjës për planifikim strategjik.

4.2. Evoluimi i strategjisë dhe integrimi i planifikimit të burimeve njerëzore

Ekzistojnë katër etapa në procesin e evoluimit të procesit të ndërlidhjes midis planifikimit strategjik të biznesit dhe menaxhmentit të burimeve njerëzore. Etapa e parë, quhet ndërlidhje administrative, ndonëse nuk ekziston një ndërlidhje reale. Drejtorët e lartë ekzekutiv veprojnë mbi supozimin se në treg të punës çdo herë mund të sigurohen profilet e kërkuara të punonjësve, dhe se roli i njësisë së burimeve njerëzore është redukuar thjesht të merren me 'punët e letrave'. Etapa e dytë, involvon ndërlidhjen njëkahëshe, në të cilën funksioni i burimeve njerëzore përfshihet vetëm në fazën e implementimit. Në etapën e tretë, realizohet ndërlidhja dy kahëshe. Kjo involvon marrëdhëniet reciproke, në të cilën funksioni i burimeve njerëzore ndihmon implementimin e planeve strategjike të kompanisë dhe siguron inputin për formulimin e strategjisë. Etapa finale, quhet ndërlidhja e integruar. Kjo etapë shkon përtej marrëdhënieve reciproke, në një involvim të barabartë me fushat e tjera funksionale të biznesit për zhvillimin e planeve strategjike të biznesit, duke përfshirë çështjet edhe jashtë burimeve njerëzore. Ndërlidhja e plotë e strategjisë së biznesit me strategjinë dhe planifikimin e burimeve njerëzore mund të përshkruhet si lidhje jo formale.

4.3. Faktorët që përcaktojnë integrimin

Ndërlidhja e strategjisë së biznesit dhe e planifikimit të burimeve njerëzore ndikohet nga shumë faktorë, duke përfshirë faktorët mjedisor siç janë konkurrenca e fortë, e cila shpesh kërkon përmirësimin e produktivitetit dhe zvogëlimin e fuqisë punëtore; ndryshimet teknologjike, që kërkojnë shkathësi të ndryshme të punëtorëve; dhe ndryshimet në kompozimin e fuqisë punëtore. Integrimi është në shkallë më të ulët në mjediset e qëndrueshme.

Një faktor tjetër është niveli i shumëllojshmërisë (diversifikimit). Integrimet më të mëdha bëhen në kompanitë me një biznes kryesor dominues, kurse integrimet janë më të dobëta në kompanitë që karakterizohen me shumëllojshmëri biznesesh. Te kompanitë me shumëllojshmëri biznesesh një strukturë e decentralizuar është shumë më e mundur. Integrimi më i madh ndodh kur drejtorët e lartë ekzekutiv të burimeve njerëzore kanë status të barabartë me drejtorët e fushave të tjera funksionale dhe kanë përvojë kredibël si menaxher linjash. Integrimet më të mëdha ndodhin edhe kur ekzistojnë mungesa të punëtorëve me

shkathësi të caktuara. Po ashtu integritime ndodhin edhe kur sistemet e kompensimit shpërblejnë performansën e drejtorëve ekzekutiv.

Një mënyrë në të cilën mund të demonstrohen dobitë nga planifikimi i burimeve njerëzore është dhënë nga këshilla në vijim nga drejtori i planifikimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore në kompaninë Corning Glass: “Identifiko çështjet që përbëjnë problem për menaxherët e linjave, më pas shpjego se si planifikimi i mirë i burimeve njerëzore mund të ndihmojë të zgjidhen disa nga ato probleme.” Siç kemi përmendur edhe më sipër, kërkesat e ndryshueshme për shkathësi poashtu ushtrojnë ndikim në shkallën e integritimit të strategjisë së biznesit dhe strategjisë dhe planifikimit të burimeve njerëzore. Me rënien e përpjestimit në raportin punonjës – prodhimi dhe shërbimet, është paraqitur edhe ndryshimi në kërkesë për shkathësi të punonjësve. Në industrinë e shërbimeve, ekziston bashkëveprimi ndërmjet krijimit dhe konsumit të shërbimeve nga konsumatorët. Për rezultat, punonjësit që punojnë në shërbime duhet të përfshihen më tepër në kontrollin e kualitetit, të bëjnë rregullime të përshtshme kur nuk përmbushen standardet, dhe duhet të jenë përgjegjës për mbikëqyrjen e tyre. Ndryshimet e tilla diktojnë që punëtorët e shërbimeve të përfshihen më tepër dhe më me përkushtim për organizatën.

4.4. Kushtet në të cilat integritimi nuk do jetë i përshtatshëm

Integritimi strategjik është i përshtatshëm vetëm pasi që funksioni menaxhmentit të burimeve njerëzore të ketë shënuar progres nëpër format dhe etapat e mëhershme të zhvillimit. Në fakt, autorët Baird dhe Meshoulam konstatojnë se faktor përcaktues i efikasitetit të funksionit të menaxhmentit të burimeve njerëzore është shkalla në të cilën harmonizohet me zhvillimin e përgjithshëm të organizatës¹⁶. Për shembull, pa një krahasim menaxherial të proceseve si skanografia mjedisore, zhvillimi i strategjisë, dhe zinxhiri menaxherial, burimet e e shpërndara për integritim strategjik do të humben. Për më tepër, një program i sofistikuar për kompensim mund të dështoi sepse sistemet e informacionit dhe të administrimit që kërkohen për implementimin e tij mund të mos jenë zhvilluar fare. Nga kjo del se niveli i zhvillimit të menaxhmentit të burimeve njerëzore duhet të harmonizohet me nivelin e zhvillimit të organizatës prind. Pesë etapat e zhvillimit organizativ janë si në vijim:

Inicimi, fillimi apo etapa e sipërmarrjes që karakterizohet me informalitet

Rritja funksionale, etapë në të cilën zhvillohet specializimi funksional dhe një strukturë formale

Rritja e kontrolluar, etapë në të cilën është aplikuar menaxhmenti profesional, janë zgjeruar linjat e prodhimit, dhe janë të theksuara produktiviteti dhe kontrolli i kostove

Integritimi funksional, etapë në të cilën është rritur koordinimi për zgjidhjen e probleme të ndërvarshmërisë ndërmjet funksioneve dhe është shënuar një rritje në theksimin strategjik

Integritimi strategjik, etapa finale e zhvillimit në të cilën ekziston fleksibiliteti i përshtatshmërisë së fuqisë punëtore, përdorimi në shkallë të gjerë i punës ekipore, shpërndarje e gjerë e përgjegjësive të burimeve njerëzore dhe inputi në procesin e bërjes së vendimeve strategjike.

Menaxheri i burimeve njerëzore dhe planifikimi strategjik

5.1. Vështrim hyrës

Funksioni i burimeve njerëzore shpesh dështon të luaj rolin e duhur në procesin e formulimit të strategjisë së organizatës për arsye të planifikimit jo adekuat të drejtorëve ekzekutiv të burimeve njerëzore. Mirëpo, vështirësitë e planifikimit nuk janë të njëjta për të gjithë ata drejtor ekzekutiv. Në të vërtetë, menaxherët nga të gjitha fushat funksionale kanë probleme me planifikimin strategjik. Në këtë seksion do të diskutojmë ato probleme të përgjithshme dhe do të adresojmë implikimet specifike për menaxhmentin e burimeve njerëzore.

5.2. Problemet e planifikimit

Është e njohur mirë se menaxherët janë të orientuar sipas veprimeve, shpesh duke preferuar ndërveprimin e procesit të vendimmarrjes me veprimet e zgjidhjes së problemeve. Është e kundërta kur bëhet fjalë për planifikimin. Një pjesë e procesit të planifikimit kryehet në izolim. Mungon informacioni nga feedback-u apo njohuritë për rezultatet për zgjatjen e periudhave kohore. Për më tepër, është vështirë të arsyetohet koha e nevojshme për planifikim në relacion me problemet tjera imediate që presin për një zgjidhje të arsyeshme. Kështu, pavarësisht nga vlera e tij, shumë menaxher nuk preferojnë të planifikojnë fare. Veç këtyre problemeve të përgjithshme të planifikimit, ekzistojnë edhe probleme të tjera në lidhje me planifikimin strategjik sepse ai shpesh rezulton me rialokimin e burimeve të cilat përcaktojnë fuqinë dhe statusin. Efektet e dëshirës që të ruhet një status quo, përmes rezistencës ndaj ndryshimit, janë të qarta në simptomet siç janë mbrojtja e tepruar e burimeve ekzistuese të alokuara, grumbullimi i informacionit, dhe kontrolli i tepruar i procesit të planifikimit përmes manipulimit me agjendat. Përpjekjet për të ruajtur një situatë status quo poashtu mund të shifin qartë në simptomet siç janë kërkesat e tepruara për fonde buxhetore.

Baird and Meshoulam. “Managing Two Fits of Strategic Human Resource Management.” Page 296 STRATEGIC HUMAN RESOURCE MANAGEMENT Section Two

Shkaqet e tjera të problemeve në procesin e planifikimit strategjik përfshijnë edhe mospërputhjen midis detyrave të planifikimit dhe shkathësive individuale të menaxherëve. Planifikimi strategjik kërkon aftësi të menduar kreativ në kontekst të organizatës si tërësi dhe marrëdhënieve midis organizatës dhe një numri të tërë faktorësh nga mjedisi që ndikojnë në cilësinë e planifikimit. Aftësia për të parë strukturën në aspektin makro është më e rëndësishme se sa procesimi i pjesëve të informacionit për të gjetur një zgjidhje për problemet në aspektin mikro. Një simptom i një mospërputhje të tillë është prirja për të rrëshqitur prapa në çështjet operacionale dhe mosaftësia për të kryer detyrat.

Dhe përfundimisht, problemi final është mungesa e përkushtimit të drejtorëve të lartë ekzekutiv për qasje serioze dhe të përgjegjshme procesit të planifikimit strategjik. Simptomt e këtij problemi përfshijnë përpjekjet e menaxherëve të lexojnë mes rreshtave për të përcaktuar pikëpamjet reale të menaxhmentit të lartë ekzekutiv mbi rëndësinë e procesit të planifikimit strategjik. Duke përmbledhur të gjitha këto vështirësi bëhet e qartë se problemi themelor është mungesa tipike e mekanizmave të shpërblimit për performancë të lartë në planifikim.

5.3. Kërkesat për menaxherët strategjik të burimeve njerëzore

Drejtorëve të lartë ekzekutiv të burimeve njerëzore herë pas here u mungon kualifikimi për të marr një rol me rëndësi në procesin e planifikimit strategjik të kompanisë. Kërkesat për ata të cilët mund të veprojnë në menaxhmentin strategjik të burimeve njerëzore shkojnë përtej kërkesave të kompetencës funksionale. Hulumtimet shkencore mbi karakteristikat e rolit shplojnë se janë të nevojshme këto kualifikime personale për një përfshirje kompetente në procesin e planifikimit strategjik:

- a. Shkathësi të menaxhmentit të informacionit—statistika, analiza, dhe punë kërkimore;
- b. Shkathësi për planifikim—njohuri për planifikimin dhe për metodologjitë e planifikimit plus teknikat statistikore; Shkathësi për menaxhment—shkathësi në funksione të ndryshme të biznesit dhe analizës së mjedisit të kompanisë; Shkathësi për integrim—kompetencë në menaxhimin e ndërhyrjeve organizative, dhe shkathësi për vlerësimin e organizatës plus përcaktimin e prioriteteve; dhe Shkathësi për menaxhmentin e ndryshimit — shkathësi për të parashikuar të ardhmën, për të ndihmuar ndryshimet, dhe për të zhvilluar aktivitete organizative.

Edhe nëse lëm mënjanë përzgjedhjen e drejtorëve ekzekutiv të burimeve njerëzore mbi bazë të këtyre kualifikimeve, dobësitë që kartakterizojnë personelin aktual mund të tejkalohen me tejkalimin e mospërputhjeve në njohuritë themelore për rëndësinë strategjike të burimeve njerëzore për implementimin e strategjisë kompetitive të kompanisë si tërësi. Për shembull, duke bashkuar shkathësitë e planifikimit me shkathësitë e shtypit në ofset dhe krijimi i ekipeve për planifikim mund të minimizojë efektet negative të dobësive kognitive të individëve. Poashtu, detyra e planifikimit mund të ndahet në etapa, disa nga të cilat mund të performohen edhe nga ata individ të cilat karakterizohen me mungesë të shkathësive kognitive për formulimin e strategjisë. Për shembull, përgjegjësi më të mëdha për grumbullimin e informacionit mund t'iu shpërndahen pikërisht atyre individëve të cilët karakterizohen me dobësi në fushën e mendimit strategjik. Përdorimi i ekipeve për të 'kompensuar' dobësitë e individëve të caktuar duket se rezulton me sukses: "Megjithëse 'menaxherët universal' mund të kenë humbur kredibilitetin, një 'konfiguracion ekipor i menaxhmentit universal' duket të ketë fituar popullaritet."¹⁷

6. Konkluzion

Shumë organizata po kuptojnë se burimet e tyre njerëzore po u sigurojnë avantazhe kompetitive. Ky vlerësim, dhe një mjedis me pasiguri në rritje, presioni në rritje për të kontrolluar kostot, dhe rregullimi qeveritar gjithnjë në rritje, kanë rritur rolin strategjik të menaxhmentit strategjik të burimeve njerëzore. Si rezultat, sot gjithnjë e më tepër po rritet involvimi i menaxhmentit të burimeve njerëzore në formulimin e strategjisë së përgjithshme të organizatës.

Në të gjitha rastet kur burimet njerëzore përbëjnë një burim të avantazheve kompetitive për organizatën, menaxhmenti i burimeve njerëzore luan një rol me rëndësi për sigurimin e inputit paraprak në nivel të procesit të planifikimit strategjik të kompanisë.

Planifikimi i burimeve njerëzore siguron një ndërlikdhje tjetër shumë me rëndësi me strategjinë organizative duke siguruar një input për disponueshmërinë e fuqisë punëtore me rëndësi kryesore për implementimin e strategjisë së përgjithshme kompetitive të kompanisë, dhe duke themeluar një ekip drejtues që merret me menaxhimin e mungesave / tepicave të fuqisë punëtore në periudha të caktuara kohore.

Inpute të tjera strategjike të funksionit të menaxhmentit të burimeve njerëzore përfshijnë skanografinë e mjedisit dhe inteligjencën kompetitive.

Në nivelin pasues të formulimit të strategjisë, strategjitë e burimeve njerëzore ndihmojnë të bashkërendojnë praktikatat e personelit, politikat, dhe programet, me strategjinë, në atë mënyrë që rolet dhe sjelljet e dëshiruara të punonjësve të mbështesin strategjitë e ndryshme (p.sh., risimet, përmirësimi i cilësisë, ulja e kostove).

Tipologjia e aktiviteteve tregon se si aktivitetet e burimeve njerëzore ndryshojnë sa i përket kontributit të tyre implementimit të strategjisë. Autorët Sonnenfeld dhe Peiperl kishin paraqitur një tipologji e cila jep shpjegime mbi dallimet në strategji

Lenz and Lyles. "Managing Human Problems in Strategic Planning Systems."

të burimeve njerëzore, relacionin e tyre me strategjitë organizative, dhe dallimet në praktikat dhe politikat e personelit nëpr industri të ndryshme¹⁸.

Organizatave dhe degëzuar apo rrjeti i organizatave poashtu kanë rëndësi të madhe për diskutimin e strategjisë së burimeve njerëzore sepse ato implikojnë sfida të reja. Ndonëse disa funksione tradicionale të burimeve njerëzore mund të jenë të panevojshme në organizata të tilla, pjesa kryesore e punonjësve të tyre permanent do të kërkojë nivele të jashtëzakonshme të trajnimit dhe të zhvillimit të shkathësive.

Një aspekt tjetër kritik i formulimit të strategjisë është edhe strategjia ndërkombëtare e burimeve njerëzore. Përveç vendimeve nëse duhet ndjekur strategjitë e shoqërive shumëkombëshe apo strategjitë globale, kompanitë duhet të zgjidhin problemin e burimeve njerëzore në mënyrë që mos t'i zhvleftësojnë shkathësitë e burimeve njerëzore me rastin e ndonjë aleanca ndërkombëtare (bashkim apo shkrirje).

Pavarësisht nga zhvillimet bashkëkohore, në shumë kompani, edhe më tutje ekziston nevoja e integritimit më të fuqishëm të planifikimit të burimeve njerëzore me procesin e formulimit të strategjisë organizative.

Faktorët që influencojnë nivelin e integritimit inkludojnë dallimet ndërmjet industrive, lëkundjet në aktivitetin ekonomik, ndryshimet e vazhduara të teknologjisë, dhe ndryshimet e vazhduara demografike. Ne kemi paraqitur në këtë punim disa raste të integritimit, duke shpjeguar edhe pengesat që kishin kufizuar integritet e tilla.

Përfundimisht, duke përmbledhur duhet të konstatojmë se menaxherët e burimeve njerëzore duhet me përkushtim të zhvillojnë shkathësitë e nevojshme personale, në mënyrë që të krijojnë kompetencë për kontribut më të madh procesit të formulimit të strategjisë së kompanisë si tërësi.

Referenca bibliografike

- Porter, Michael E. *Competitive Advantage: Creating and Sustaining Superior Performance*. Page 281 STRATEGIC HUMAN RESOURCE MANAGEMENT Section Two.
- Dyer, Lee. "Bringing Human Resources into the Strategy Formulation Process," *Human Resource Management* 22, no. 3 (1983): 257–71.
- ARCO. *ARCO Annual Report*, 1986.
- Wright, Patrick M., and Gary C. McMahan. "Theoretical Perspectives for Strategic Human Resource Management," *Journal of Management* 18, no. 2 (1992): 295–320.
- Quinn, James B. *Strategies for Change: Logical Incrementalism*. Homewood, IL: Richard D. Irwin, 1980, p. 7.
- Henn, William R. "What the Strategist Asks from Human Resources," *Human Resource Planning* 8, no. 4 (1985): 195 (whole article on pp. 193–200).
- Ohmae, Kenichi. *The Mind of the Strategist*. New York: Penguin Books, 1988, p. 42.
- Higgins, James M., and Julian W. Vincze. *Strategic Management: Text and Cases*. Chicago: Dryden Press, 1989.
- Craft, James A. "Human Resource Planning and Strategy," in Lee Dyer (Ed.), *Human Resource Management: Evolving Roles and Responsibilities*. Washington, DC: Bureau of National Affairs, 1988, p. 53.
- Quinn, James B. "Retrospective Commentary," *Sloan Management Review* 30, no. 4 (1989): 55–60.
- Porter, Michael E. *Competitive Advantage: Creating and Sustaining Superior Performance*.
- Miles and Snow. "Designing Strategic Human Resources Systems"; Sonnenfeld and Peiperl. "Staffing Policy as a Strategic Response." Schuler. "Strategic Human Resources Management: Linking the People with the Strategic Needs of the Business," p. 24.
- Craft. "Human Resource Planning and Strategy"; Beer, Spector, Lawrence, Mills, and Walton. *Managing Human Assets*.
- Baird and Meshoulam. "Managing Two Fits of Strategic Human Resource Management." Page 296 STRATEGIC HUMAN RESOURCE MANAGEMENT Section Two
- Lenz and Lyles. "Managing Human Problems in Strategic Planning Systems."
- Sonnenfeld, Jeffrey, and Maury A. Peiperl. "Staffing Policy as a Strategic Response: A Typology of Career Systems," *Academy of Management Review* 13, no. 4 (1988): 588–600; Lengnick-Hall, Cynthia A., and Mark L. Lengnick-Hall. "Strategic Human Resources Management: A Review of the Literature and a Proposed Typology," *Academy of Management Review* 13, no. 3 (1988): 454–70. Page 286 STRATEGIC HUMAN RESOURCE MANAGEMENT Section Two

Sonnenfeld, Jeffrey, and Maury A. Peiperl. "Staffing Policy as a Strategic Response: A Typology of Career Systems," *Academy of Management Review* 13, no. 4 (1988): 588–600; Lengnick-Hall, Cynthia A., and Mark L. Lengnick-Hall. "Strategic Human Resources Management: A Review of the Literature and a Proposed Typology," *Academy of Management Review* 13, no. 3 (1988): 454–70.

SHQIPËRIA, STALINI, HRUSHOVI, THYERJA E MARRËDHËNIEVE DHE RITAKIMI DIPLOMATIK NË VITIN 1990

JULJANA KRISAFI

Doktorante pranë Universitetit Europian të Tiranës,
Fakulteti i Shkencave Sociale, Dega Marrëdhënie Ndërkombetare
Email: julikrisafi@hotmail.com

ABSTRAKT

Në këtë punim duke bërë një përmbledhje të marrëdhënies së Enver Hoxhës me Bashkimin Sovjetik, ajo që dua të ve në pah dhe të theksoj është fakti që Enver Hoxha ishte një trashëgimtar i Stalinit. Një adhurues i tezave të tij dhe modelit të tij politik. Hoxha nuk mundi asnjëherë të dalë jashtë këtij profili. Une e shoh këtë fakt si arsyen kryesore të konfliktit të tij me Titon e me pas me Hrushovin . Kulti i individit nuk e lejonte të pranonte rotacionin dhe humbjen e pushtetit vetjak . Ai nuk mundi asnjëherë të hidhte poshtë kultin e individit edhe pse u perpoq sa për sy e faqe ta bënte këtë pas kongresit të XX-të të PK-së së BS-së. Nikita Hrushov në kujtimet e tij për Shqipërinë, kujtonte edhe njëherë se Konferenca e Tiranës do të kishte sjellë demokratizimin në Shqipëri, sikur të ishin zëvendësuar Hoxha, Shehu dhe Balluku. Por faktet treguan që Enver Hoxha me diplomacinë e tij të përlujes së përhershme kur bëhej fjalë për pushtetin vetjak shpërthente në deklaratat me një gjuhë të ashpër, më të ashprën e vënë re ndonjëherë në kampin socialist madje edhe në ditët më të acarta të tij. Prishja e marrëdhënieve shqiptaro - sovjetike duke analizuar dokumentacionin, dëshmitë e faktet, mund të shpjegohet si një përpjekje e Enver Hoxhës për të shpëtuar regjimin e tij dhe qëndrimin e tij në pushtet, se sa si një konflikt ideologjik, siç është paraqitur deri vite më parë. Nje aspekt i rëndësishëm i paranojës së Enver Hoxhës është edhe figura e Josip Broz Titos. Cili është vendi i tij në këtë marrëdhënie të ndërlikuar dhe a ka qenë vërtet ai një nga shkaqet kryesore të nisjes së furtunës mes të dy vendeve.

Në librin e tij “Hrushovianët” Enver Hoxha shkruante: “Ne kishim ëndërruar natë e ditë, të takonim Stalinin. Gjatë periudhës së luftës nacional çlirimtare kjo dëshirë u bë edhe më e fortë.... Stalini zhvilloi drejt luftën e klasave , goditi pa mëshirë (dhe bëri shumë mirë) armiqetë e socializmit . Ai u tregua një marksist - leninist i shquar ”

Dhe Enver Hoxha ishte i sinqertë në ato që thoshte për Stalinin. Ai mbeti deri në vdekje një stalinist besnik.

Në vitet 1948 -1961 Shqipëria dhe Bashkimi Sovjetik patën marrëdhënie shumë të ngushta. Intensiteti i tyre ishte kaq i madh saqë Shqipëria ekonomikisht por edhe politikisht ishte plotësisht e varur nga Bashkimi Sovjetik. Afrimi nisi me përkrahjen në OKB. Delegacioni i parë shqiptar mbërriti në Moskë në vitin 1947, ku takoi Stalinin, udhëheqësin e superfuqisë, e cila doli nga lufta fitimtare dhe dukej sikur në atë kohë nuk pyeste për kërkënd. Dëshmitarë të këtij takimi të parë kujtojnë se këtë takim Stalini e shfrytëzoi për të marrë disa informata rreth këtij vendi të vogël në Ballkan. Ai dëshironte të njihet me historinë, gjeografinë dhe gjuhën tonë. Që prej njesjes së marrëdhënieve e deri në 1953-ishin kur Stalini vdiq, marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik nuk patën kurrë probleme. Si fillim Bashkimi Sovjetik nuk e shprehu drejtpërdrejt interesin për ne, por edhe përse i përket eksperiencës Stalini i këshilloi shqiptaret ta merrnin atë nga bullgarët dhe jugosllavët edhe për shkak të afërsisë gjeografike.

Deri në vitin 1948 pavarësisht se marrëdhëniet diplomatike me Bashkimin Sovjetik ishin vendosur me kohë, çdo gjë zhvillohej me bekimin e Beogradit. Furtuna në marrëdhëniet midis Moskës dhe Beogradit solli ndarjen e madhe të Enver Hoxhës me Titon. Dhe ishte kjo koha kur Bashkimi Sovjetik doli hapur në interesin e tij ndaj Shqipërisë. Pozita jonë në kanalin e Otrantos dhe fqinjësia me Greqinë dhe Jugosllavinë e nxiti Bashkimin Sovjetik që të mbante Shqipërinë si kartë presioni ndaj fqinjëve duke i premtuar asaj siguri dhe mbështetje. Dhe Enver Hoxha donte pikërisht mbështetje përballë Jugosllavisë armike tashmë, por edhe mbështetje financiare aq të nevojshme për të kapërcyer varfërinë e tejskajshme të vendit...

Gjatë punës në arkivin e shtetit në kërkim të shënimeve, ditareve, kujtimeve, telegrameve, letrave, pra komunikimit mbi dhe nenujor të asaj kohe del qartë një fakt. Ne ishim në çdo qelizë të varur nga sovjetikët. Enver Hoxha bindej për çdo gjë. Ai kishte kaq shumë nevojë për ato para që i jepte Bashkimi Sovjetik për të mbajtur gjallë frymën e këtij vendi ekstremisht të varfër në Europë. Për çdo detaj qeveria e Enver Hoxhës konsultohet me ta, për çdo investim, deri tek shkarkimet nga puna të punonjësve do të ishin të diktuar ose të kritikuar nga sovjetikët. Shqipëria komuniste raportonte rregullisht për çdo lëvizje dhe frymëmarrje me frikën permanente se një ditë Bashkimi Sovjetik mund të na ndërpriste kreditë, furnizimet me lëndë të parë, apo se do të gjendeshim të pambrojtur përballë tashmë armiqve jugosllavë. Kaq i pazëshëm dukej Enver Hoxha dhe zëvendësit e tij në takimet me ta sa që figurën e tij prej diktatori e gjithë kjo histori të bën ta shohësh në një dritë tjetër. Në një nga dokumentet sekrete të asaj kohe Lavrentij Beria. koka e shërbimeve sekrete të Stalinit, me ashpërsi i kërkonte udhëheqësve shqiptarë të spastronin radhët e ushtrisë pasi 30 për qind e tyre ishin spiunë. Por në opinionin e historianëve ne ishim një vend i vogël dhe nuk mund të vepronim ndryshe në marrëdhëniet me një superfuqi të përmasave të Bashkimit Sovjetik. Parë në këtë këndvështrim në marrëdhëniet në mes dy palëve jo gjithmonë ka barazi, ekziston edhe kjo lloj përlulesie, ekziston edhe një lloj marrëdhënie disproporcionale ndërmjet, por këto janë deri në një farë mase normale. Për këtë periudhë vlera jonë kryesore ka qenë siç thuhet në dokumentet e perëndimit jo aq rëndësia e një shteti me performancë të caktuar por ka qenë më shumë pozita strategjike e Shqipërisë në Mesdhe. Ia vlen të theksohet se në pamje të parë duket sikur udhëheqësit shqiptarë janë gjithmonë të përlulur por duhet të kemi parasysh se mbi ta ushtrohet edhe një lloj presioni. Por ndoshta thellë thellë Enver Hoxha nuk përulë se shqetësohet për varfërinë e tejskajshme të popullit të tij, por për pushtetin vetjak. Per karrigen e tij ai kishte qenë gjithmonë i përlulur. Iu përul më herët Miladin Popoviçit dhe Dushan Mugoshës gjatë luftës, faktet tregojnë se iu përul Titos si askush tjetër, iu përul sovjetikëve e më pas kinezëve.

Shpesh herë mentorët sovjetikë na akuzonin për shpenzime të papërgjegjshme dhe për investime në fusha në të cilat do të dështonim. Enver Hoxha ishte i prirur të investonte në industrinë e rëndë ndërkohë që këshillat që vinin nga BS-ja ishin për të investuar në industrinë ushqimore, bujqësi e peshkim. Më vonë kur shkruajti librin “Hrushovianët” Enver Hoxha i gjykonte si kurth antishqiptar këshillat sovjetike për tu marrë me bujqësi, madje ai citonte këshillat e tyre me ironi : Shqipëria të ecë përpara me pambuk, dele, peshk e agrume....

Shqipëria nuk ishte një aleat i papërfillshëm për Bashkimin Sovjetik në atë kohë dhe duhet theksuar për shkak të pozitës strategjike të vendit tonë.

Kjo gjë u materializua me ndërtimin e bazës ushtarake detare në gjirin e Vlorës por edhe me shumë marrëveshje ushtarake. Dokumentat britanike janë shumë interesante. Në to shkruhet se pas prishjes me Jugosllavinë mendohej që baza do të ndërtohej në Shqipëri. Më herët, në vitin 1952 apo ‘53, thuhet se në gjirin e Vlorës është futur një avion zbulimi britanik me firmën e Çurçillit për të parë nëse po ndërtohej me të vërtetë një bazë nëndetësesh në gjirin e Vlorës . Megjithatë një pyetje qëndron ende pa përgjigje. Ky vend që paska pasur një rëndësi strategjike të dorës së parë për Bashkimin Sovjetik si u la aq lehtë dhe si ikën këta të fundit dhe u tërhoqën kur Shqipëria ishte vija e parë e Bashkimit Sovjetik në detin Mesdhe?! Ndoshta vlera strategjike e Shqipërisë duhet parë në mënyrë relative. Deri në 1948-ën, interesi ishte investuar mbi Jugosllavinë. Ishte

dëshira e Bashkimit Sovjetik për ta lënë Shqipërinë të influencohej kaq shumë nga Jugosllavia. Vetëm pas ndarjes me Titon, Shqipëria u kthye totalisht nga Bashkimi Sovjetik.

Ishte vet Marrëshalli Zhukov që në vizitën e tij në 1957-ën në Shqipëri shprehu admirimin e madh për bazën e Pashalimanit në jugperëndim të Shqipërisë....

Sovjetikëve, gjiri i Vlorës u dukej i mrekullueshëm, Deti i Zi ku ata kishin një pjesë të madhe të flotës ishte në fakt një liqen krahasuar me të. Ata donin ta dislokoinin atë flotë në këtë bazë duke pushtuar në këtë mënyrë gjithë Mesdheun. Ëndrra e tyre do të bëhej realitet, flota e tyre do të dilte në Mesdhe dhe atëherë nga Gjibraltari në Suez dhe deri në Dardanele ata do të sundonin Mesdheun.

Në fakt Zhukovi dhe sovjetikët nuk e pushtuan ndonjëherë Mesdheun e për më tepër as nuk u munduan ta bënin këtë....

Por ekzistonte një zonë me kontraste të forta në marrëdhëniet tona me sovjetiket. Një çështje për të cilën Enver Hoxha nuk u perul kurrë. Edhe pse i rrezikohej seriozisht pushteti. Marrëdhëniet me Jugosllavinë. Pavarësisht varësisë nga BS-ja dhe pavarësisht ndikimit të tyre tek ne, përsëri ata nuk arritën kurrë të bindnin diktatorin të rregullonte marrëdhëniet me Titon.

Marrëdhënia me Jugosllavinë ishte një nga arsytet e rëndësishme për thyerjen e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik. Nikita Hrushov në librin e tij "Unë nuk jam gjykatës" tregon se Enver Hoxha ishte përpjekur t'i imponohej që të mos rregullonte marrëdhëniet me Titon. Kurse Enver Hoxha pretendonte të kundërtën. Ai shkruante më vonë se ata që përpiqeshin të imponoheshin ishin sovjetikët. Ata donin që shqiptarët jo vetëm t'i zbutnin sulmet ndaj jugosllavëve, por madje duhet të fillonin dhe të kishin marrëdhënie normale, duke devijuar së bashku me jugosllavët nga rruga e marksizëm - leninizmit. Kishte shumë arsye që e ndanin Enver Hoxhën nga Hrushovi. Që nga Stalini dhe modeli i tij, e deri tek vendi i Kinës në bllok. Por Enver Hoxha, nuk ishte absolutisht dakort me qëndrimin ndaj komunizmit të jugosllavëve. Në kujtimet e tij, Enver Hoxha e konsideronte Titon tradhëtarin e marksizëm - leninizmit ndërsa Hrushovi jugosllavët i shihte si komunistë të mirëfilltë. Enver Hoxha ishte i bindur se Hrushovi donte një vëllatë vogël që ta mbante nën sjetull dhe vet të merrte rolin e vëllait të madh. Sipas arsytimit të tij Hrushovi e donte Titon se ky i fundit ishte i pari që i doli kundër Stalinit. Stalinit të madh, modelit të të cilit Enver Hoxha i qëndroi besnik deri në vdekje. Shumë historianë e shpjegojnë thjesht si problem pushteti. Sigurisht këtu ka edhe dicka të vërtetë. Pajtimi me Jugosllavinë ka dhe një aspekt tjetër të rëndësishëm, ky veprim do të thoshte shfaqim për jugosllavët dhe fajësim për atë pjesë të udhëheqjes shqiptare që i dënoi jugosllavët. Në majën e kësaj piramide ishte vet Enver Hoxha por edhe të tjerë persona, Mehmet Shehu etj. Nëse do të pranonin gabimet me Jugosllavinë nuk ishte cudi që do të binte kredibiliteti i tyre në sytë e popullit shqiptar por edhe do të mund të zevendesoheshin me persona të tjerë që do të ecnin në të njëjtën linjë me udhëheqjen sovjetike të Hrushovit.

Ndër të tjera ka historianë që i gjejnë themelet e prishjes edhe tek çështja e Kosovës dhe qëndrimi i udhëheqjes jugosllave ndaj saj. Por po të shohim kujtimet e Hrushovit. edhe ai i mëshon marrëdhënieve të Shqipërisë me Jugosllavinë në funksion të çështjes së pazgjidhur të Kosovës.

Pas vizitës në 1959 në Shqipëri dhe pritjes shumë të ngrohtë, Hrushovi u shpreh një vit më vonë mjaft I zhgënjyer nga justifikimet që nxirrnin shqiptarët për prishje të marrëdhënieve. Gjate vizitës së tij në Shqipëri sigurisht nuk shkoi gjithçka vaj. Analizuesit e kohës kanë dalluar edhe ato mosmarrëveshjet që ekzistonin pavarësisht nga deklaratat që dukeshin sikur ishin në të njëjtën rezonancë. Por vetëm një vit më vonë në mbledhjen e Moskës në nëntor të 1960-ës Hrushovi thotë kur dëgjon shqiptarët. Ose unë jam budalla ose ju jeni shumë ë djallëzuar....

Por viti 1961 ishte fundi i një ftohje të gjatë. Në nëntor të 1960 Enver Hoxha dhe njerëzit e tij morën pjesë në kongresin e 81 partive që u zhvillua në Moskë. Pozicionimi i izoluar i Shqipërisë pro Kinës kundër Bashkimit Sovjetik, paralajmeronte furtunë. Incidenti i radhës përkoi me mbledhjen e traktatit të Varshavës në Moskë po në nëntor 1960. Gjeneralët shqiptarë guxuan ti kthenin fjalën marrëshallit Grecko dhe të tjerëve. Mbledhja u prish dhe hendeku ishte hapur shumë i thellë.

Duke filluar nga gushti 1960, BS-ja ushtroi një presion shumë të madh ndaj udhëheqjes shqiptare, dhe presion nga brenda. Dokumentet perëndimore flasin për një lëvizje të brendshme për një grusht shteti nga brenda përmes personave që ishin të afërt me politikën e re sovjetike. Dhe burimet më të mëdha për këtë lloj informacioni vijnë më së shumti nga italianët dhe nga grekët ose nga amerikanët në Beograd etj. Përveç rrezikut të brendshëm për të cilin flasin shumë dokumente amerikane dhe britanike, një problem që është trajtuar gjerësisht nga ata por është pretenduar edhe nga udhëheqja shqiptare, është idea e një sulmi të mundshëm si shenjë hakmarrje për atë që ajo bëri, ndërmarrë nga BS-ja, e ndoshta edhe nga Jugosllavia. Këto dokumenta e lakojnë shumë këtë problem.

Duhet të kemi parasysh konjunkturën politike ndërkombëtare që sulmi ndaj Shqipërisë të duket i pamundur. Shqipëria për më tepër nuk ka patur lidhje territoriale as me BS-në dhe as me shtetet e tjera të traktatit të Varshavës. Të ndërmerrje një aksion kundër Shqipërisë do të krijonte një konflikt ndërkombëtar. Në kujtimet e tij Hrushovi shkruan se në Shqipëri zbatohet një sistem i tillë nëse dikush gabonte dhe këtë e konstatojnë Hoxha, Shehu dhe Balluku, atëherë të tre bashkë jepnin ndëshkimin. E tëra kjo i ngjante shumë mënyrës që zbatonte Stalini për zhdukjen e kundërshtarëve. Liderët shqiptarë, me metodat e tyre të ekzekutimeve të fshehta dhe të hapura, krijuan një parti e cila mbahej e bashkuar vetëm nga frika, shkruante

lideri sovjetik. Bashkimi Sovjetik i nderpreu marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë në 3 dhjetor 1961 në një kohë kur retorika kishte arritur pikën maksimale të agresivitetit dhe egërsisë. Enver Hoxha nuk i kurseu fjalët kundër Hrushovit dhe grupit të tij. Ai e quajti udhëheqësin sovjetik puçist dhe me synime djallëzore kundër Shqipërisë. Në një dokument sekret që mban datën 26 korrik 1989, citohet pak a shume se në atë kohë në Moskë u mbledh një komision I sekretariatit të komitetit qëndror të Bashkimit Sovjetik me specialistë që janë marrë me Shqipërinë. Komisioni konkludoi se në vitet '60 Bashkimi Sovjetik kishte vepruar gabim ndaj Shqipërisë dhe se për këtë i duhej kërkuar falje asaj. Pra sovjetikët i morën gjithë fajet mbi vete dhe vendosën që ti kërkojnë palës shqiptare normalizimin e marrëdhënieve. Bashkimi Sovjetik pranoi se ajo që ishte bërë kundër Shqipërisë ishte e dhimbshme dhe se për gabimet e bëra nuk do të heshte. Pala sovjetike shprehte gatishmërinë për ti bërë ato të njohura në të gjitha mjetet e informacionit duke kërkuar falje publikisht. Bashkimi Sovjetik nuk do të kishte asnjë pretendim ndaj Shqipërisë dhe ishte i gatshëm e i vendosur të mos vendoste ndonjë kusht ndaj vendit tonë pasi kishte detyrime internacionaliste ndaj saj. Por përgjigjia e qeverisë së Tiranës erdhi e ftohtë dhe mohuese. Për arsytet që dihen” ne nuk kemi dhe as do të kemi marrëdhënie me Bashkimin Sovjetik” thuhet në të.....

Një vit më vonë në korrik 1990 Shqipëria dhe Bashkimi Sovjetik rivendosën marrëdhëniet. Dhe arsytet që e detyruan Ramiz Alinë një vit më vonë të ndryshonte mendje dhe të dërgonte një delegacion me në krye këshilltarin e tij më të afërt Sofo Lazrin, për të negociuar në pranverën e 1990-ës në Sofie të Bullgarisë duket se kanë të bëjnë me faktin që udhëheqja shqiptare nuk donte të vendoste marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik para vendosjes së marrëdhënieve me SHBA-të apo Britaninë e madhe. Të armatosur me një valixhe plot me dokumenta me anë të të cilave do të justifikonin veten se Shqipëria nuk kishte asnjë faj përkundrejt Bashkimit Sovjetik, përkundrazi, shqiptarët hasën në dashamirësinë, tolerancën dhe një diplomaci tashmë moderne nga ana e sovjetikëve

POLITIKAFISKALEDHETATIMOREGJATË VITEVE TË TRANZICIONIT NË KOSOVË

NAIM GASHI

UET, Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit
Departamenti i Financës

ABSTRAKT

Studimi i thelluar i impaktit të politikave fiskale në faza të ndryshme të tranzicionit ekonomik në Kosovë, përqendrimi tek studimi i një prej elementeve thelbësore të politikave tatimore, siç është TVSH, synojnë të kenë një vlerë akademike dhe njëkohsisht të ndihmojnë debatin profesional lidhur me hartimin, implementimin dhe pershtatjen e politikave fiskale në faza të ndryshme të tranzicionit ekonomik në Kosovë.

Politika Tatimore e një shteti është pjesë e politikës fiskale që lidhet me përcaktimin e llojeve të tatimeve të zbatuara në një vend, përcaktimin e nivelit, llojeve dhe përqindjeve të tatimeve, me burimet e ndryshme të të ardhurave, me raportin optimal ndërmjet tatimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta, si dhe me llojet dhe masat e lehtësimeve të ndryshme tatimore.

Përveç funksionit të sigurimit të të ardhurave buxhetore, politika dhe sistemi tatimor i çdo vendi luan një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë, të arsimit; kulturës; shëndetësisë; punësimit etj.

Me Ligjet e reja të aprovuara, me zgjerimin e bazës fiskale dhe aplikimin e tatimeve të reja, sistemi i tatimeve në Kosovë po bëhet gjithnjë e më kompatibil me sistemet tatimore të vendeve në tranzicion dhe të vendeve të zhvilluara, ndërsa si kontribuesi më i madh në të ardhurat buxhetore është Tatimi në Vlerën e Shtuar (TVSH)

Rrjedhimisht, në kuader të këtij punimi, ne do të fokusohemi me teper tek politika tatimore, në vecanti tek TVSH e aplikuar gjatë këtyre viteve, në Kosovë.

Në këtë drejtim, nga ky studim synoj që të arrijë deri të konkluzione dhe rekomandime të vlefshme, të cilat do të hyjnë në shërbim institucioneve tatimore, dhe që do t'i kontribuojnë ngritjes së performansës së tyre në nivel më të lartë, karshi nevojës për stabilitet financiar të buxhetit shtetëror.

STRATEGJIA PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM EKONOMIK NË RAJONIN PERËNDIMOR TË KOSOVËS

PHD(c) ARDIAN BERISHA

Universiteti Europian I Tiranës, Fakulteti Ekonomik, Profili Menaxhim

ABSTRAKT

Sikurse në çdo ekonomi në zhvillim shtytja kryesore strategjike qëndron në sektorin publik, për të krijuar kushtet që do të inkurajojnë dhe lehtësojnë gjenerimin e pasurisë dhe krijimin e vendeve të punës. Kjo do të jetë unike për të gjitha Zonat Ekonomike në Kosovë, megjithatë qasja e adaptuar nga Rajoni Perëndimor i Kosovës është njohja e rëndësisë së mjedisit dhe bukurive natyrore të imazhit të tij në syrin e banorëve, vizituesve dhe investuesve.

Strategjia e cila është miratuar përpiqet të drejtoj zhvillimin në atë mënyrë që të minimizojë ose madje edhe të parandalojë dëmtimin e mjedisit nëpërmjet një qasjeje hapësinore të kontrolluar, kryesisht duke u bazuar në infrastrukturën ekzistuese. Paralelisht me krijimin e kushteve për rritje ekonomike dhe përmirësimin e imazhit të rajonit Perëndimor të Kosovës, biznesi ekzistues duhet të jetë më konkurrues dhe të inkurajohet për të synuar shtimin e vlerës për produktet e tyre.

Në Perëndim të Kosovës, agro-biznesi përbënë një aktor kryesor ekonomik, ky sukses është bazuar në kushtet e dobishme lokale dhe traditën afatgjate të prodhimit me cilësinë në rritje e sipër, por në kontekstin ndërkombëtarë duhet të bëhet më shumë për të shtyrë këtë sektor drejt zhvillimeve të shekullit XXI dhe ta ndihmojë atë që të konkurroj me mallera dhe shërbime sa me cilësore.

Po ashtu ekziston turizmi i bazuar në bukuritë natyrore dhe kulturë, si dhe ka potencial për rritje, mirëpo është i kufizuar nga mungesa e investimeve dhe është një inkurajim i mirë për bizneset dhe të qenit konkurrues në treg.

Fjalë kyç: *Zhvillim, Strategji, Inkurajim, Rajon, Mjedis*

Hyrja

Një nga faktorët e rëndësishëm për zhvillimin e suksesshëm dhe të qëndrueshëm ekonomik dhe me ndikim të dukshëm në zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e nivelit të jetesës, është dhe mbetet edhe krijimi i një mjedisi sa më të përshtatshëm për zhvillimin e sektorit privat, të biznesit. Nga ana tjetër, përmirësimi i vazhdueshëm i klimës së biznesit dhe marrëdhënieve Qeveri - Biznes mbi baza ligjore, ka një ndikim të konsiderueshëm në instalimin dhe konsolidimin e ekonomisë së tregut dhe të reduktimit gjithnjë e më të madh të ekonomisë informale.

Sektori i bizneseve të vogla dhe të mesme ka një potencial të pallogaritshëm për të kontribuar në rritjen ekonomike, hapjen e vendeve të punës dhe zbutjen e varfërisë. Sidoqoftë, që bizneset e vogla dhe të mesme të japin efektet e dëshiruara, sipërmarrësit duhet të jenë të motivuar që të ngrënë biznese të ligjshme dhe që sipërmarrjet e tyre të mund të mbijetojnë. Faktori më i rëndësishëm për të bindur sipërmarrësit që të punojnë në mënyrë të ligjshme dhe për t'i ndihmuar që të mbijetojnë, është mjedisi i biznesit. Mjedisi i pafavorshëm me taksa të larta, korrupsion dhe burokraci shtypëse, kompromenton më tej premiset për sukses.

Strategjia e biznesit të qëndrueshëm ekonomik në rajonin e Kosovës

Korniza ligjore për krijimin e mjedisit të biznesit në Kosovë

Që nga viti 2008, janë bërë një numër i të arriturave kyçe të cilat kanë rezultuar në disa përmirësime të mjedisit të biznesit për NVM-të në Kosovë. Në shtatë vitet e fundit (që nga koha kur Kosova në shkurt të vitit 2008 shpalli pavarësinë) është bërë një reformë e madhe tatimore dhe është bërë riorganizimi i arkëtimit të TVSH-së përmes arkave fiskale, përkundër kundërshtimit të disa shoqatave të biznesit. Këta ishin tre hapat kryesor në tentimet për uljen e shkallës së informalitetit në sektorin e NVM-ve dhe për të provuar përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet komunitetit të biznesit dhe shtetit. Të hyrat tatimor janë rritur dukshëm për shkak të uljes së shkallës tatimore nga 20% në 10% në kombinim me përmirësim të zbatimit të tyre, zgjerimit të bazës tatimore dhe një riorganizim më të madh dhe më efikas të procesit të arkëtimit të tatimeve.

Janë bërë disa përmirësime në çështjet ligjore dhe administrative dhe tani NVM-të mund të regjistrohen përmes pilot Qendrave Komunale të Biznesit (QKB) themeluar me përkrahjen e Bankës Botërore. Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) duhet të punojë në drejtim të regjistrimit online dhe të një numri të vetëm të regjistrimit për kompanitë të cilat aplikojnë në të gjitha institucionet shtetërore siç janë: regjistri i biznesit, autoriteti tatimor dhe fondi pensional, për të mundësuar zvogëlimin e numrit të hapave administrativ për regjistrim.

Marrëveshja për tregti preferenciale ndërmjet Kosovës dhe BE-së ka skaduar në fund të vitit 2010. Mbetet të shihet nëse një përpjekje e përbashkët ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe partnerëve ndërkombëtar do të rezultojë me përmirësim të qasjes së mallrave dhe shërbimeve të Kosovës në tregjet ndërkombëtare dhe drejtë anëtarësimit në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT). Paralelisht me objektivin qendror afatgjatë të Kosovës për anëtarësim në OBT, është me rëndësi jetësore që komuniteti i NVM-ve në Kosovë të përqendrohet në përmirësimin e qasjes në tregjet rajonale të Shqipërisë, IRJM-së dhe Malit të Zi.

Mjedisi i të bërit biznes në Kosovë

Klima e biznesit dhe e investimeve përbëhet jo vetëm nga niveli i taksave dhe incentivave fiskale të disponueshme për bizneset. Komponentë të tjerë vendimtare janë edhe stabiliteti politik, shteti i së drejtës, kushtet makroekonomike, perceptimet e qeverisë dhe mjedisi rregullator.

Gjendja e mjedisin e të bërit biznes dhe të investimeve të një shteti është një faktor kyç i aftësisë së këtij shteti për të thithur investime të huaja dhe për të zhvilluar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Ndërmarrjet ndërnacionale parapëlqejnë të investojnë në vende me klimë të shëndetshme biznesi ku kostot, vonesat dhe risku janë të minimizuar.

Në Studimin për Mjedisin e Biznesit dhe Performancën e Ndërmarrjeve (BEEPS) të mbajtur në vitin 2008, pronarët e bizneseve kishin identifikuar korrupsionin, furnizimin me energji elektrike, krimin, vjedhjet dhe parregullsinë² si pengesat kryesore për të bërë biznes në vendin tonë.

Indeksi i Transformimit i Fondacionit Bertelsmann (BTI)³ analizon dhe vlerëson nëse vendet në zhvillim dhe ato në tranzicion drejtojnë ndryshimet shoqërore drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut dhe si e bëjnë këtë. Nga gjithsej 128 shtete të përfshira në këtë indeks, Kosova radhitet në vendin 41 në Indeksin e Statusit dhe cilësohet si shtet i limituar.

Në transformimin politik Kosova radhitet në vendin 43 dhe cilësohet si demokraci e mangët, ndërsa në transformimin ekonomik radhitet në vendin 58 dhe cilësohet si ekonomi me mangësi funksionale. Në Indeksin e Statusit, vendet e rajonit hyjnë në radhët e shteteve të avancuara. Kroacia radhitet e 15-ta, Serbia e 21-ta, Maqedonia e 25-ta, Mali i Zi i 27-ti dhe Shqipëria e 31-ta.

Qeveria e Kosovës, "Strategjia e zhvillimit të NVM-ve në Kosovë 2012 – 2016 me vizion 2020", Korrik 2011, fq. 12.

BERZH, "Business Environment and Enterprise Performance Survey", publikim në linkun <http://www.ebrd.com/pages/research/economics/data/beeps/beeps09.shtml>

Indeksi i Transformimit i Fondacionit Bertelsmann, Bertelsmann Stiftung, 2012

Indeksi për Perceptimin e Korrupsionit nga Transparency International për vitin 2012 e rangon Kosovën në vendin e 105 nga gjithsej 176, e parafundit nga shtetet e Ballkanit⁴. Nga ana tjetër, rregulloret e punës konsiderohet si shumë fleksibile dhe marrja e lejeve nga administrata tatimore dhe lejet e biznesit janë më pak problematike se sa në shtetet tjera të rajonit. Mali i Zi ka indeksin më pozitiv, prej 4.0 dhe radhitet në vendin 66. Atë e pasojnë Maqedonia me indeks 3.9 në vendin 69, Serbia me indeks 3.3 në vendin 86, Bosnja dhe Hercegovina me indeks 3.2 në vendin 91 dhe Shqipëria me indeks 3.1 në vendin 95.

Sa i përket ekonomisë joformale dhe përkrahjes së investimeve, ndonëse ekziston një plan veprimi i azhurnuar për të adresuar ekonominë joformale dhe për eliminim e barrierave administrative ekzistuese si dhe janë krijuar fonde garantuese për eksport, si dhe shumë barrierat e të bërit biznes janë hequr, mund të themi se ka pak ose nuk ekziston fare një analizë gjithëpërfshirëse mbi atë se çfarë ndikimi kanë pasur këto plane të veprimit në zhvillimin ekonomik, përkatësisht në zbutjen e shkallës së lartë ekzistuese të papunësisë, gjë që veçse është bërë kronike.

Në përgjithësi, ekziston një konsensus në mes akterëve të ndryshëm se Kosova ka arritur deri më tani të tërheqë një sasi të vogël të investimeve të duaja direkte kryesisht të koncentruar në sektorët e shërbimeve dhe atë financiar, me vetëm përafërsisht 8.5% të BPV-së⁶, edhe për shkak të një mjedisi jo të favorshëm të të bërit biznes, që theksohet edhe në raportin e Komisionit lidhur me Studimin e Fizibilitetit “në mënyrë që të përmbush detyrimet në kuadër të MSA-së, Kosova duhet të sigurojë kushte stabile, transparente dhe të parashikueshme për investitorët e huaj”⁷.

Mjedisi i të bërit biznes në Kosovë është i vështirë, megjithëse autoritetet janë duke bërë përpjekje për përmirësimin e situatës. Në raportin e Bankës Botërore “Të Bësh Biznes” për vitin 2013, rangimi i përgjithshëm i Kosovës është ngritur nga vendi 126 në vendin e 98 (nga gjithsej 185 vende)⁸. Problemet më të madhe shfaqen në marrjen e lejeve të ndërtimit dhe ekzekutimin e kontratave. Kosova gjithashtu ka vështirësi në fillimin e një biznesi dhe në tregtinë ndërkufitare.

Nëse e analizojmë performancën e Kosovës në dhjetë indikatorët e TBB, shohim që marrja e kredisë është indikator i ku Kosova renditet më së miri kurse marrja e lejes për ndërtim më e dobëta. Më poshtë kemi paraqitur performancën e Kosovës në TBB për vitin 2012 dhe 2013.

TABELA 1. PËRFORMANCA E KOSOVËS NË RAPORTIN E BANKËS BOTËRORE E TË BËRIT BIZNES (TBB)

Indikator	Renditja në 2013	Renditja në 2012
Fillimi i Biznesit	126	170
Marrja e Lejes për Ndërtim	144	177
Sigurimi i Energjisë Elektrike	116	122
Regjistrimi i Pronës	76	74
Marrja e Kredisë	23	23
Mbrojtja e Investitorëve	100	176
Pagesa e Taksave	44	48
Tregtia përmes Kufijve	124	133
Zbatimi i Kontratave	138	139
Zgjidhja e Pamundësisë së Borxhit	87	86

Burimi: Banka Botërore “Raporti i të Bërit Biznes”, publikimet e vitit 2012 dhe 2013

Nga viti 2010, Kosova është përfshirë në Raportin e të Bërit Biznes me matje në të gjitha kategoritë. Ky raport, i publikuar në fund të vitit 2010, e radhiti Kosovën në vendin 117 nga 183 shtete në botë. Këto matje të para për Kosovën janë shumë të rëndësishme për t’i përdorur si bazë për shënimin e përparimit në secilën nga kategoritë e raportit TTB.

Strategjia e biznesit në Kosovë në raport me vendet e rajonit

Sa i përket pozitës së Kosovës në raport me vendet e rajonit për fushën e të bërit biznes del se gjatë periudhës 5 vjeçare mes 2008-2012, sipas Bankës Botërore rajoni në tërësi ka shënuar ngritje në rejtingun e të bërit biznes ku në vitin 2008 sipas

Publikim në linkun http://www.kdi-kosova.org/publications/2012_CPI_brochure_EN.pdf

Task Forca për Integrim Evropian; “Tryeza Tematike Nr. 4 për Tregti, industri, dogana, tatime, treg të brendshëm, konkurrencë, mbrojtje të konsumatorit dhe atë shëndetësore”, Prishtinë 2012, fq. 16.

Komunikata e Komisionit lidhur me Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit mes BE dhe Kosovës, fq. 35

Po aty fq. 38.


Banka Botërore, “Doing bussines 2013”, edicioni i 10-të, publikim në linkun <http://www.doingbusiness.org/reports/global-reports/doing-business-2013>

mesatares së rejtingut të të gjitha shteteve të rajonit është klasifikuar i 86-ti për tu ngritur disa shkallë më lartë tek vendi i 77-të në vitin 2012 (shih grafikun 1).

Megjithatë, jo të gjitha shtetet e rajonit kanë shënuar ngritje në këtë aspekt. Turqia, Bullgaria, Rumania, Serbia dhe BeH, të gjitha kanë shënuar rënie ashtu sikurse dhe Kosova, ndërsa shtetet tjera të rajonit kanë pasur ngritje. Maqedonia ka shënuar ngritjen më të shpejtë brenda kësaj periudhe, ku nga vendi i 79-të në vitin 2008 është ngritur në vendin 22-të në vitin 2012, duke u klasifikuar kështu si vendi i parë në rajon me ambient më të mirë të të bërit biznes në vitin 2012.

Ndërsa nëse shikohet mesatarja e klasifikimeve të përvjetëshme brenda periudhës 2008-2012, Maqedonia radhitet e dyta në listë duke shënuar vendin e 49-të në botë për të bërë biznes, menjëherë pas Sllovenisë e cila sipas mesatares së përvjetshme të klasifikimit për të bërë biznes është e 48-ta në botë apo e para në rajon.


GRAFIKU 1. REJTINGU PËR TË BËRIT BIZNES I RAJONIT (2008-2012)



Vendet e fundit në rajon për të bërë biznes i zë Kosova dhe BeH, të cilat janë të renditura në vendin 121-të, respektivisht e 117-ta në botë për të bërë biznes gjatë periudhës 2008-2012. Ky pozicionim i Kosovës në këtë raport ndikon që Kosova të ketë një pozitë të pafavorshme në raport me fqinjët në tërheqjen e IHD-ve nga vendet e eurozonës. Për më shumë informata lidhur me renditjen e të gjitha shteteve të rajonit gjatë periudhës 2008-2012 shih grafikun 8.

Sa i përket vendeve fqinje të Kosovës, e fundit në listë është Shqipëria e cila brenda periudhës 2008-2012 mesatarisht është klasifikuar në vendin 93-të për të bërë biznes, afro 20 vende më lartë se Kosova siç shihet në grafikun e mëposhtëm. Mali i Zi dhe Serbia janë të renditura shumë afër Shqipërisë, ku Mali i Zi brenda kësaj periudhe është renditur i 92-ti ndërsa Serbia në vendin e 91-të brenda të njëjtës periudhe. Sa i përket blloqeve në rajon, vendet e CEFTA-së janë ato që kanë shënuar ngritjen më të madhe në klasifikimin botëror të të bërit biznes, kjo për shkak të rritjes së theksuar të Maqedonisë në këtë aspekt si anëtare e CEFTA-së.

GRAFIKU 2. RENDITJA E TË GJITHA SHTETEVE TË RAJONIT GJATË PERIUDHËS 2008-2012



Të dhënat për ambientin e të bërit biznes për të gjithat shtetet e rajonit për vitet respektive 2008-2012 janë marrë nga: The World Bank, "Doing business", 2012, <http://www.doingbusiness.org/reports/global-reports/doing-business-2012>, 2011.

Megjithatë, si është treguar më lartë, përmirësimi i renditjes nuk do të thotë që do të ketë rritje të IHD. Në vitet e fundit të treguesve të TBB, ka pasur dy shtete që janë përkushtuar në masë më të madhe në reforma për përmirësimin e renditjes, Maqedonia dhe Gjeorgjia. Të dy këto shtete kanë qenë ndër reformuesit kryesor dhe kanë arritur që brenda një kohe të shkurtër të përmirësojnë renditjen e tyre në këtë raport. Sot, Gjeorgjia qëndron në vendin e nëntë, ndërsa Maqedonia në vendin 23-të. Sidoqoftë, investimet e huaja direkte jo vetëm që nuk janë rritur proporcionalisht me përmirësimin e renditjes në raportin e të bërit biznes, por ka pasur raste kur ato edhe kanë pësuar rënie.

Nëse i krahasojmë IHD me renditjen në TBB në mes të Kosovës dhe Maqedonisë shohim që, duke e anashkaluar vitin 2009, në vitin 2010 Kosova kishte 220% të IHD të totalit të Maqedonisë, duke qenë në vendin 113 për dallim prej Maqedonisë në vendin 32. Në vitin 2011, Kosova u ndodh në vendin 117, Maqedonia në vendin 38, ndërsa Kosova këtë vit mori 133% të investimeve totale që i mori Maqedonia¹⁰.

TABELA 2. RËNDITJA SIPAS MJEDISIT TË TË BËRIT BIZNES NË SHTETET FQINJE TË KOSOVËS

Shtetet	2008	2009	2010	2011	2012
Maqedonia	79	71	36	38	22
Mali i Zi	92	103	87	90	86
Serbia	91	94	90	89	95
Shqipëria	135	86	81	82	82
Kosova	0	0	118	119	126
Mesatarja	89	71	82	84	82

Kryesisht, Kosova u vonua në krijimin e kushteve që do të lehtësonin të hyrat nga IHD. Vendimi i qeverisë i vitit 2009 për t'i ulur taksat u dëshmuar të jetë i pamjaftueshëm në tërheqjen e IHD-ve. Nevojiten masa shtesë për të krijuar një ambient të shëndoshë biznesi. Aktualisht, Kosova vazhdon të jetë e pafavorshme për investitorë; madje edhe ata investitorë që dikur e shihnin Kosovën si zonë të investimeve potenciale janë tërhequr për shkak të pasigurisë politike dhe korrupsionit të shtrirë.¹¹

Ndikimi i Raportit të të Bërit Biznes në mjedisin dhe strategjinë e biznesit

Renditja e shtetit në raportin e TBB çdo ditë e më shumë po ndikon politik-bërjen e shteteve, posaçërisht atyre në zhvillim. Ekziston një keqinterpretim nga politikbërësit e shumë vendeve në zhvillim i cili dikton që nëse politikat publike fokusohen në përmirësimin e renditjes në raport, do ta përmirësojnë edhe mjedisin për zhvillim të biznesit dhe të sektorit privat në përgjithësi.

Njëkohësisht këta politikbërës mendojnë se raporti shërben si udhëzues për investitorët potencial dhe sa më pozitiv të jetë ai aq më shumë ka gjasa për rritjen e investimeve të huaja. Sipas Grupit të Vlerësimit të Pavarur (IEG), 85% e politikbërësve e marrin parasysh radhitjen e shtetit të tyre në raportin e të bërit biznes si shtytë për reforma, mirëpo shumica e tyre nuk e cilësojnë si udhërrëfyes për të vepruar¹².

Nga kjo shihet që ndikimi i raportit të të bërit biznes është shumë më i madh në politikbërësit e një vendi se sa në investitorët potencial. Raporti i të bërit biznes ka një numër të madh të mangësive, të cilat tentojnë të përmirësojnë klimën e të bërit biznes, por nuk garantojnë zhvillim. Raporti ka ndikim më të madh në vendet në zhvillim, vende këto që pësojnë nga politikat që kanë prioritet përmirësimin e radhitjes në TBB mbi politikat që do të kishin rezultate në zhvillim ekonomik.

Raporti i të bërit biznes lë anash një numër faktorësh që vendet në zhvillim mund t'i dëmtojë në të ardhmen. Bazat e këtij raporti nuk inkurajojnë përfshirje më aktive të femrave në biznes e as nuk e promovojnë rëndësinë e një fuqie punëtore të kualifikuar. Në anën tjetër, raporti merr parasysh vetëm të dhënat për një kategori të caktuar të ndërmarrjeve që operojnë në kryeqytet duke i anashkaluar kështu bizneset e vogla dhe të mesme në vendet tjera, posaçërisht ato rurale. Kjo gjithashtu rezulton në mungesën e reformave të cilat do t'i ndihmonin ndërmarrjet e tilla që në vendet në zhvillim janë bartësit kryesor të ekonomisë vendore.

Përfundimi

Në Raportin e Progresit të KE-së për Kosovën 2010, janë identifikuar tri barriera kryesore me të cilat përballen bizneset në Kosovë. Barriera e parë ka të bëjë me furnizim jo të qëndrueshëm me energji elektrike dhe me ujë të cilat janë posaçërisht serioze për NVM-të prodhuese. Gjithashtu, si një prej barrierave kryesore për zhvillim të shpejtë të NVM-ve është konsideruar

INDEP, (2012); "Kufizimet e raportit të të bërit biznes", Analizë e politikave publike për avancimin e ndërmarrësisë në Kosovë përmes përmirësimit të indikatorëve të Raportit të të Bërit Biznes të Bankës Botërore, Prishtinë, fq. 14.

Shërbimi Këshilldhënës Multi-Donator për Mjedis të Investimeve i Grupit të Bankës Botërore, "Studimi i perceptimit të investitorëve të huaj për Kosovën." Vjenë, Maj 2009.

Raporti i të Bërit Biznes: Një Vlerësues i Pavarur, Banka Botërore dhe Grupi i Pavarur i Vlerësimeve. 2008

edhe qasja e kufizuar në burimet financiare. Barriera e tretë është sundimi i pamjaftueshëm i ligjit, i cili ka ndikim tek të gjithë qytetarët e Kosovës.

Që nga viti 2008, kemi një numër arritjesh të rëndësishme të cilat kanë rezultuar në disa përmirësime të mjedisit të biznesit për NVM-të në Kosovë. Në shtatë vitet e fundit (që nga koha kur Kosova në shkurt të vitit 2008 shpalli pavarësinë) është bërë reforma tatimore dhe është riorganizimi i arkëtimit të TVSH-së përmes arkave fiskale, pavarësisht kundërshtimit të disa shoqatave të biznesit. Këto ishin zhvillime të rëndësishme në drejtim të uljes së shkallës së informalitetit në sektorin e NVM-ve dhe të përmirësimit të marrëdhënieve ndërmjet komunitetit të biznesit dhe shtetit. Të hyrat tatimore janë rritur dukshëm për shkak të uljes së shkallës tatimore nga 20 në 10 %, si dhe të përmirësimit të zbatimit të ligjit, zgjerimit të bazës tatimore dhe riorganizimit më të mirë dhe më efikas të procesit të arkëtimit të tatimeve.

Literatura

- Qeveria e Kosovës, “Strategjia e zhvillimit të NVM-ve në Kosovë 2012 – 2016 me vizion 2020”, Korrik 2011, fq. 12.
- BERZH, “Business Environment and Enterprise Performance Survey”, publikim në linkun <http://www.ebrd.com/pages/research/economics/data/beeps/beeps09.shtml>
- Indeksi i Transformimit i Fondacionit Bertelsmann, Bertelsmann Stiftung. 2012 Publikim në linkun http://www.kdi-kosova.org/publications/2012_CPI_brochure_EN.pdf
- Task Forca për Integrim Evropian; “Tryeza Tematike Nr. 4 për Tregti, industri, dogana, tatime, treg të brendshëm, konkurrencë, mbrojtje të konsumatorit dhe atë shëndetësore”, Prishtinë 2012, fq. 16.
- Komunikata e Komisionit lidhur me Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës, fq. 35
- Po aty fq. 38.
- Banka Botërore, “Doing bussines 2013”, edicioni i 10-të, publikim në linkun <http://www.doingbusiness.org/reports/global-reports/doing-business-2013>
- Të dhënat për ambientin e të bërit biznes për të gjithat shtetet e rajonit për vitet respektive 2008-2012 janë marrë nga: The World Bank, “Doing business”, 2012, <http://www.doingbusiness.org/reports/global-reports/doing-business-2012>, 2011.
- INDEP, (2012); “Kufizimet e raportit të të bërit biznes”, Analizë e politikave publike për avancimin e ndërmarrësisë në Kosovë përmes përmirësimit të indikatorëve të Raportit të të Bërit Biznes të Bankës Botërore, Prishtinë, fq. 14.
- Shërbimi Këshilldhënës Multi-Donator për Mjedis të Investimeve i Grupit të Bankës Botërore, “Studimi i perceptimit të investitorëve të huaj për Kosovën.” Vjenë, Maj 2009.
- Raporti i të Bërit Biznes: Një Vlerësues i Pavarur, Banka Botërore dhe Grupi i Pavarur i Vlerësimeve. 2008

SI NDIKON SISTEMI ELEKTORAL NË REZULTATET E ZGJEDHJEVE POLITIKE!

PHD CANDIDATE AURORA BALUKJA

Universiteti Europian i Tiranës

Lektore tek Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan

auroralukja@yahoo.com

ABSTRAKT

Sistemi elektoral është një grup rregullash, të cilat janë mjaft të ndryshme dhe të shumëllojta, dhe nga mënyra se si kombinohen këto rregulla, kemi sistemet zgjedhore. Sistemi elektoral përcakton rregullat e lojës demokratike dhe si pasojë është edhe përcaktuese në rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve politike. Sistemi zgjedhor mund të përkufizohet si mekanizmi i cili përkthen votat në mandate sepse ai është i përbërë nga një tërësi rregullash që pranohen në një demokraci përfaqësuese për të transformuar preferencat e zgjedhësve në vota dhe votat në vende të parlamentit.

Është e domosdoshme që shtetet të hartojnë rregulla, të cilat përcaktojnë se cilët njerëz do të hipin në pushtet, si rrjedhojë e një rezultati të votimeve dhe këta rregulla njihen si sistemi elektoral i shtetit. Këto rregulla janë rezultat i marrëveshjeve të fshehta ose jo, të partive më të mëdha politike. Me përcaktimin e sistemit elektoral, përcaktohet edhe mënyra e votimit, pra kemi një ndikim edhe në seleksionimin e kandidatëve brënda partive politike. Sistemet elektorale gjithashtu ndikojnë në stabilitetin dhe funksionalitetin e sistemeve politike dhe të qeverisjes. Dallohen përgjithësisht tre grupe të mëdha të sistemeve të votimit: kemi sistemin maxhoritar, në të cilat partitë e mëdha fitojnë në mënyrë tipike një numër të madh vendesh në parlament, sesa sasia e votave që kanë fituar gjatë zgjedhjeve; sistemin proporcional, që garantojnë një marrëdhënie të barabartë, midis vendeve të fituara nga një parti dhe votave të marrë gjatë zgjedhjeve; dhe sistemin e përzier të votimit, ku kombinojnë njëherësh mënyrat proporcionale dhe ato maxhoritare. Në këtë punim, do të trajtoj gjërësisht se cili është sistemi elektoral më i mirë për realitetin shqiptar.

Fjalë kyç: *Sistem elektoral, Sistemi maxhoritar / sistem proporcional / sistem i përzier, Partitë politike, Seleksionimi i kandidatëve, Vota.*

Hyrja

Në vitet 1980-të dhe 1990-të, demokratizimi dhe mbajtja e zgjedhjeve u përshpejtuan me një shkallë të paparë. Në ato vite menaxhimi i zgjedhjeve u bë më i sofistikuar. Gjithnjë e më shumë pranohet se zgjedhjet e suksesshme arrihen me anë të një administrate të plotësuar me personel profesional, të pajisur mirë dhe të financuar në mënyrë adekuate. T. S. Seshan, ish-kryekomisioner i zgjedhjeve në Indi dhe njeriu përgjegjës për zgjedhjet në demokracinë më të madhe botërore bënte këto komente në vjeshtën e vitit 1996-të: «...zgjedhjet e mira kërkojnë katër elemente: një ligj të zgjedhjeve të ujditur plotësisht që të sigurojë zgjedhje të lira dhe të drejta; një komision të zgjedhjeve që të jetë vërtetë autonom dhe pa frikë; procedura që mundësojnë që burri edhe gruaja më e vogël të mund ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votimit lirisht dhe pa frikë; dhe një elektorat që është plotësisht i vetëdijshëm për të drejtat dhe përgjegjësitë e veta.”

Pra, përzgjedhja e sistemit të zgjedhjeve është një nga vendimet institucionale më të rëndësishme për çdo demokraci. Shpesh përzgjedhja është e rastit, rezultat i kombinimit jo të zakonshëm të rrethanave, të një trendi kalimtar, ose të historisë së huaj. Megjithatë, thuajse në të gjitha rastet përzgjedhja e një sistemi të veçantë të zgjedhjeve ka ndikim themelor në jetën e ardhshme politike të vendit në fjalë.

Një sistem elektoral i mirë, i përshtatshëm me situatën e vendit dhe në mënyrë që të paraqesë sa më mirë vendimin e sovranit, ai është sistemi më i mirë dhe i përshtatshmi për vendin tonë. Këtu do të trajtojmë tre familjet e mëdha të sistemeve elektorale (mazhoritar, gjysmëproporcional dhe proporcional), avantazhet dhe disavantazhet e tyre. Sistemi elektoral, i cili mund të jetë mazhoritar ose proporcional, përcaktohet në kushtetutë dhe mund të ndryshohet kur qeveritarët e mendojnë të nevojshme. Në Kushtetutë është e përcaktuar moshja edhe cili ka të drejtë të votojë dhe vota duhet të ketë të njëjtën peshë për të gjithë.

Në këtë punim, do të përdor metodën cilësore, ku do të paraqes përmbledhjen e literaturës rreth kësaj teme. Qëllimi i këtij punimi, është të evidentojë rëndësinë e madhe që ka përzgjedhja e sistemit elektoral për zhvillimin e zgjedhjeve dhe për ndikimin që ka sistemi, në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. Këtu do të trajtoj konceptet si, zgjedhjet, demokracia, sistemi electoral (mazhoritar, gjysmëproporcional dhe proporcional).

Sistemet e zgjedhjeve

Sistemi zgjedhor mund të përkufizohet si mekanizmi i cili përkthen votat në mandate. Bëhet fjalë për një sistem i cili edhe pse konsiderohet si një metodë e thjeshtë numerike që kthen votat në mandate, përfaqëson përkufizimin e një sistemi politik fryt i zgjedhjeve delikate dhe i një vullneti politik të një konteksti të caktuar.

Në bazë të sistemit zgjedhor zhvillohet dhe “loja” demokratike, i cili përbën procesin e legjitimitetit demokratik (përfaqësimin politik) sepse duke transformuar votat në mandate ndikon jo vetëm në stabilitetin qeverisës por edhe në sistemin partiak.

Sistemi mazhoritar: Kemi të bëjmë me një sistem antik, i cili favorizon stabilitetin qeverisës. Sipas teorisë së Sartorit, kemi të bëjmë me një sistem i cili ka një natyrë të tijen specifike: të sigurojë me siguri një fitues dhe si pasojë një sistem i qeverisshëm. Të krijojë një mazhorancë dhe një opozitë pa u shqetësuar shumë për principin e përfaqësimit të votës. Sistemi tipik i familjes mazhoritare është i ashtuquajturit plurality system-first pass the post i bazuar në një sistem mazhoritar me zonë elektorale një emërore me një turn dhe me mazhorancë relative. Ky lloj sistemi mundëson ardhjen në pushtet të një qeverie të përbërë nga një numër i vogël partish. Minimizohen koalicionet e fragmentizuara, të ashtuquajturat “aleanca fluide”, të cilat vështirësojnë ecurinë e reformave e në këtë mënyrë dhe qeverisjen e vendit. Me një sistem të tillë është më lehtë të përcaktohen përgjegjësitë për ata që qeverisin. Po ashtu sistemi mazhoritar mundëson një ndarje më të qartë mes opozitës dhe pozitës dhe eviton rrezikun e formimit të një klase politike që qëndron gjithmonë në pushtet pavarësisht nga rezultatet e zgjedhjeve. Sistemi i pastër mazhoritar u jep përparësi dy partive kryesore dhe interesat e individëve që nuk preferojnë asnjërin prej tyre, nuk merren në konsideratë. Këta individë ndodhen nën presionin e idesë se gjithsesi kandidati i partisë së tyre duke qenë i një partie të vogël, nuk do të fitojë, prandaj ata votojnë për njërin nga partitë kryesore për të mos e ecuria dëm votën e tyre.

Sistemet zgjedhore proporcionale: lindën në mes të shek. XIX dhe përhapja e tyre maksimale ndodh me zgjerimin e të drejtës së votës. Është një sistem i cili respekton në mënyrën më të besueshme të mundur rezultatet e zgjedhjeve dhe vullnetin e zgjedhësve duke ofruar një fotografi pothuajse egzak të elektoratit. Garanton përfaqësimin e forcave të ndryshme politike dhe i jep mundësi partive të vogla politike të mund të përfaqësojnë elektoratin e tij në parlament. Në këtë sistem çdo votë ka vlerë dhe numri i vota që humbasim është shumë i reduktuar sesa tek sistemi elektoral mazhoritar. Nga sistemi proporcional, synohet të merret përfaqësimi, pra të merren parasysh ndarjet e brendshme të shoqërisë si dhe madhësia e zonave zgjedhore. Me sistemin proporcional bëhet e mundur që individë me interesa të veçanta, si psh pronën, të kenë mundësi që të jenë të pranishëm në parlament. Nisur nga të dhënat e mësipërme vlen të theksohet se sistemi aktual është më i përshtatshmi për vendin tonë.

Për të evidentuar ndarjen e vendeve, përcaktohet një prag elektoral, që i jep mundësi partive politike për të hyrë në Parlament. Numri ose pragu, vendoset nga çdo vend në bazë të aritmetikës elektorale, e cila e përdor metoda të ndryshme për të përcaktuar këtë prag. Sistemet elektorale proporcionale, janë sistemet që përdoren më shumë në vendet demokratike Perëndimore. Sistemi proporcional ndahet në dy lloje: sistemi i listave partiake (votuesit votojnë rreth listës së hedhur nga

kryetarët e partive) dhe sistemi i votave të transferueshme. Sa më i vogël të jetë numri i vendeve në parlament, aq më e vështirë është të arrihet proporcionaliteti. Ky sistem inkurajon një numër të madh kandidatësh dhe inkurajon femrat dhe përfaqësues të minoriteteve ose grupeve sociale të caktuara të mund të jenë kandidatë potenciale dhe kanë më shumë shance që të fitojnë. Disavantazh për këtë sistem është se partitë e mëdha politike e kanë të vështirë të fitojnë ose të mund të qeverisin të vetme vendin, duke i bërë qeveritë e koalicionit tipike për disa vende.

Ndërhyrja e dy sistemeve bën të mundur reduktimin e defekteve të mazhoritarit (nëse nuk bëhen manipulime), anashkalon destabilitetin e proporcionalit si dhe mundëson në shkallë më të lartë qeverisjeje dhe përfaqësimi. Sistemi zgjedhor është një ndër institucionet më të rëndësishme themelore të demokracisë që duhet konsoliduar. Ndryshimi rrënjësor i tij ka pasoja afatgjata dhe të paparashikueshme. Ky ndryshim sjell me vete kosto politike, pasi duhet të rishikohen rregullat e lojës, kosto administrative, pasi është një staf i tërë që duhet të ndryshohet apo trajnohet si dhe çorientimin e votuesve, pasi është parë që me sisteme të ndryshme zgjedhore, zgjedhësit sillen në mënyrë të ndryshme. Sigurisht që ky sistem nuk është i përkryer. Ai ka nevojë për rregullime. Realiteti politik shqiptar ka treguar se ka gjetur vend për manipulime si psh i ashtuquajturit fenomen i "dushkut" apo "mega-dushkut". Këto fenomene mund të rregullohen duke njësuar votën për kandidatin me votën për partinë apo duke zhvilluar votim paralel. Avantazhet e sistemit mazhoritar.

Mund të përmendim edhe rastin e zgjedhjeve në vitin 2009-të në Shqipëri, ku Kabineti Berisha 2, vetëm duke bashkuar votat e Partisë LSI, arriti të mund të qeverisnin vendin për një periudhë katër vjeçare. Gjithashtu, edhe në zgjedhjet e vitit 2013-të, Partia Socialiste vetëm duke bërë koalicion me LSI-në, arritën të mund të merrnin pushtetin. Por kjo mënyrë qeverisëse, nëpërmjet koalicioneve, ka pasoja si positive, por edhe negative. Ky sistem i jep mundësi partive të vogla politike, femrave ose komuniteteve të ndryshme, të mund të kandidojnë për zgjedhjet dhe të jenë kandidatë potencialë për të fituar. Në këtë mënyrë, çdo grup i vogël social, ka të drejtën e përfaqësimit në Parlamentin Shqiptar. Përtej kësaj, një anë pak negative, nëse mund ta quajmë në këtë mënyrë është edhe qeveria në përmjet koalicioneve. Për disa vende tjera, me një kulturë dhe një të shkuar demokratike, qeveria e koalicionit mund të konsiderohej një faktor pozitiv sepse në këtë mënyrë partitë e ndryshme në bashkëqeverisëse mund të shërbenin si një opozitë brenda qeverisë. Ato mund të kontrollonin dhe të bashkëvendosnin me njëra-tjetrën në qeverisjen në mënyrë sa më efektive të vendit.

Por nëse flasim për realitetin shqiptar, koalicionet qeverisëse nuk kanë qenë shumë efektive dhe të dobishme. Nga eksperiencia pothuajse 6-të vjeçare në vendin tonë, vëmë re parti politike, bashkëqeverisëse, mendojnë të marrin sa më shumë portofole ministrore, që të kenë mundësi të mund të punësojnë elektoratin e tyre. Gjithashtu vëmë re se, partitë politike, për të ruajtur ekzistencën e koalicionit, ndërmarrin vendime edhe nëse mund të jenë jo produktive për të ardhmen e vendit.

Rëndësia e sistemit elektoral

Menaxhimi i zgjedhjeve ka të bëjë me përzgjedhjen e sistemit të duhur në rrethana të caktuara. Ekzistojnë shumë modele që duhet të ndjekin gjatë menaxhimit të procesit të zgjedhjeve; zgjedhja përfundimtare në masë të madhe varet nga rrethanat historike dhe kulturore të vendit në fjalë, nivelit të sofistikimit, situatës financiare dhe politike dhe arsimimit të njerëzve të tij. Menaxhmenti i zgjedhjeve po njihet si shërbim, në shumë mënyra, i krahasueshëm me sektorë më tradicional të shërbimit dhe shumë teste të efikasitetit që shfrytëzohen në këta sektorë mund të zbatohen në menaxhimin e zgjedhjeve.

"Përvoja dhe praktika shtetërore e kohëve të fundit, vërtetojnë nevojën për mbikëqyrje të procesit të zgjedhjeve... [dhe] për përgjegjësi institucionale për implementim nëpërmjet zyrtarëve të paanshëm të zgjedhjeve... Një mekanizëm mbikëqyrës që gëzon besimin e partive dhe të elektoratit, bën presion në situatat e tranzicionit, për shembull, nga sistemet njëpartiake në ato shumëpartiake, ose saherë që vihet në dyshim paanshmëria e autoriteteve administrative. Institucionalizimi efektiv i të drejtave themelore zgjedhore dhe politike i obligon shtetet... që të krijojnë një sistem të përshtatshëm elektoral, për të implementuar obligimet ndërkombëtare, sa u përket të drejtave individuale, [dhe]... që të krijojnë një mekanizëm efikas të paanshëm dhe/ose të baraspeshuar për menaxhimin e zgjedhjeve legjislativë".

Në hyrje të librit të tij, *Direito Eleitoral Positivo*, Torquato Jardim, ish-anëtar i tribunalit të zgjedhjeve të Brazilit, shkruante: «Në shtetin demokratik ku sundon ligji, i bazuar në sistemin e lirisë civile, që kushtëzohet veprimet e shtetit, i rrallë është funksioni i shtetit që i kryer në mënyrë jo të saktë ose të pamjaftueshme, mund t'i lëndojë aq shumë, aq thellë, sa administrimi i procesit të zgjedhjeve.

Me cilindo skenar qoftë, përzgjedhjet që bëhen, mund të mos jenë më të mirat për të mirën politike afatgjate të vendit në fjalë, dhe ndonjëherë mund të kenë pasoja të tmerrshme për përparimin demokratik të një vendi. Historiku i përzgjedhjes së sistemit elektoral, pra, mund të jetë aq i rëndësishëm sa edhe vetë përzgjedhja. Njeriu nuk duhet të ketë iluzion se vendimet e tilla bëhen në vakum politik. Në të vërtetë, trajtimi i përparësisë politike është thuaja gjithmonë një faktor në përzgjedhjen e sistemeve elektorale – nganjëherë kjo është e vetmja konsideratë. Si pasojë e kësaj, gjersa pranohen detyrimet praktike, ne përpiqemi t'i qasemi çështjes së përzgjedhjes së sistemit elektoral në mënyrë sa më të gjerë dhe gjithpërfshirëse.

Elementi i sistemit elektoral të këtij punimi ka për qëllim sidomos negociatorët politikë dhe hartuesit e kushtetutës në demokracitë e reja, në themelim e sipër dhe tranzicionale. Megjithatë, meqë të formësuarit e institucioneve politike është detyrë shumë e rëndësishme jo vetëm për demokracitë e reja por edhe për ato demokraci tashmë të themeluara që kërkojnë t'i përshtasin sistemet e tyre për të pasqyruar më mirë realitetin e ri politik, ky tekst po ashtu kërkon të shqyrtojë edhe shqetësimet e atyre personave si në demokracitë e themeluara ashtu edhe në ato ekzistuese që mund të jenë duke përpiluar sistemet elektorale. Gjersa konteksti në të cilin demokracitë që paraqiten dhe vendosen bëjnë zgjidhje kushtetuese dallojnë

jashtëzakonisht shumë, qëllimet afatgjata të shumicës së demokracive janë zakonisht të njëjta: të përvetësohen institucionet që janë mjaft të fuqishme për të avancuar demokracinë stabile, por mjaft fleksibile për të reaguar në rrethanat që ndryshojnë. Si demokracitë që paraqiten dhe ato tashmë të vendosura, kanë shumë për të mësuar nga përvoja e të tjerëve. Krijimi institucional është proces evolutiv, kurse ne kërkojmë të distilojmë mësimet që kemi nxënë nga shumë shembuj të vërtetë të krijimit institucional nëpër botë. Nevojiten, që sistemi elektoral i lirë dhe i drejtë, kërkon që:

Çdo qytetar të ketë të drejtë, të marrë në zgjedhje për të votuar dhe për t'u votuar,
Proceset elektorale të jenë të rregullta dhe zgjedhjet që mbahen të mënyrë periodike,
Zgjedhjet të mbahen në një atmosferë ku respektohen të drejtat themelore të qytetarëve,
Procedurat e votimit garanton lirinë, fshehtësinë dhe numërimin e saktë të votave,
Proçesi të kontrollohet nga një organizatë e zgjedhjeve që vepron në mënyrë të pavarur nga pushtetet tjera të shtetit ose të qeverisë.

Një sistem elektoral efikas, duhet të bazohet në kontrollin e kujdesshëm të shpenzimeve. Është e vërtetë se synimi kryesor i zgjedhjeve është të arrihet qeveria legjitime dhe regjimi i lirë, sidomos në një proces tranzicioni, meqë pa zgjidhjen e kësaj çështjeje themelore, nuk është e mundur të zgjidhet pjesa tjetër e problemeve sociale ose politike të vendit. Mirëpo aspekti financiar nuk mund të lihet pas dore. Asnjë vend nuk mund ta mbajë një sistem elektoral me shpezime që janë përtej kapaciteteve financiare të vendit (e më së paku nëse ekzistojnë pabarazi serioze sociale).

Në zhvillimin e kornizës ligjore më të përshtatshme për t'i rregulluar zgjedhjet, duhet të merren parasysh si vijon:

Organizimi dhe zbatimi i zgjedhjeve, kërkon një sistem rregullues të përgjithshëm, duke përfshirë që nga rregulloret kushtetuese që definojnë të drejtën aktive dhe pasive të votimit, e deri te kodet implicite dhe eksplicite të sjelljes midis konkuresve. Instrumenti parësor rregullues është ligji i zgjedhjeve. Kjo kornizë ligjore kërkon një marrëveshje të gjërë mbi përmbajtjen e saj dhe një shkallë të arsyeshme të përhershmërisë në mesin e forcave politike më të rëndësishme. Në njërin anë, funksionet e saj themelore janë përcaktimi i saktë i elementeve të sistemit dhe në anën tjetër, të krijojë një grup të garancive procedurale që do ta siguronin të drejtën e votimit. Mirëpo nuk është as praktike e as e përshtatshme të krijohen rregullore të zgjedhjeve të bazuara ekskluzivisht në ligj, që është i vështirë për t'u modifikuar. Përvoja praktike në proçeset e zgjedhjeve dëshmon domosdoshmërinë që të lihet një kufi për përshtatjen dhe interpretimin e rregulloreve administrative relevante dhe të vendimeve të autoritetit të zgjedhjeve.

Si duhet të formulohet një ligj i zgjedhjeve? Nevoja për marrëveshje politike përkritasi me rregulloret e zgjedhjeve bëhet veçanarisht evidente në periudhat e tranzicionit. Është shumë e vështirë të definohet strategjia më adekuate paraprakisht për çdo vend.

Sistemet zgjedhore dhe kushtetuta

Shumë nga krijimi kushtetues, është paraqitur në kohë relativisht të vonshme: lëvizja gjithëbotërore drejt qeverisjes demokratike në vitet e 80-a dhe të 90-a të shekullit të kaluar kanë stimuluar një urgjencë të re duke hulumtuar modele të qëndrueshme të qeverisë së përfundimit përkatës, krahas me vlerësimin e freskët të sistemeve elektorale. Ky proçes është inkurajuar me realizimin e përhapur gjerësisht se, zgjedhja e institucioneve mund të ketë ndikim të dukshëm mbi sistemin e gjerë politik – për shembull, gjithnjë e më shumë pranohet se një sistem elektoral mund të ndihmojë për të “inxhinieruar” bashkëpunimin dhe vendosjen në shoqëri të ndarë. Krijimi i sistemit elektoral tani i pranuar si me rëndësi të rëndësishme për çështje të mëdha të qeverisjes, dhe me gjasë si njëri me ndikimin më të madh, nga të gjitha institucionet politike.

Në nivelin më themelor, sistemet elektorale tregojnë se në zgjedhjet e përgjithshme, votat hidhen në vende që i fitojnë partitë dhe kandidatët. Variabilet kryesore janë:

Formula elektorale e përdorur (d.m.th. qoftë të jetë sistem me mazhorancë ose proporcional, dhe çfarë formule matematike përdoret për të llogaritur caktimin e vendeve)
Përmasa e rajonit, jo sa votues jetojnë në një rajon, por më tepër sa anëtarë të parlamentit zgjidhen në atë rajon.

Struktura e sistemit elektoral lidhet ngushtë me më shumë aspekte të tjera administrative të zgjedhjeve me të cilat kanë të bëjnë me, shpërndarja e vendeve të votimit, caktimi i kandidatëve, regjistrimi i votuesve, kush i drejton zgjedhjet dhe kështu me radhë. Këto çështje janë me rëndësi të madhe, kurse avantazhi i mundshëm i çdo përzgjedhjeje të sistemit të zgjedhjeve do të pengohet përveç nëse u kushtohet vëmendje e nevojshme. Forma e sistemit elektoral po ashtu ndikon në fushat e tjera të ligjeve elektorale: përzgjedhja e sistemit elektoral ka ndikim në mënyrën me të cilën caktohen kufijtë rajonal, si numërohen votat, krahas aspekteve të tjera të shumta të procesit elektoral.

Dhe sipas Kushtetutës Shqiptare, tek Kreu II, “Financimi i subjekteve zgjedhore”, Neni 87 “Shpërndarja dhe rishpërndarja e fondeve publike për subjektet zgjedhore”, Nr. 1, pika b): b) 50 për qind e shumës së përgjithshme ndahet midis partive politike të regjistruara si subjekt zgjedhor dhe që në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin kanë marrë jo më pak se 2 vende në Kuvend, në raport me votat e marra prej tyre në shkallë kombëtare, sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve pararendëse.

Përmbledhje e llojeve të sistemeve elektorale

Ka me qindra sistemesh elektorale aktualisht në përdorim e sipër po edhe më shumë permutacione të secilës formë, por për hir të thjeshtësisë, ne i kemi kategorizuar sistemet elektorale në tri familje të gjëra:

Mazhoritar (të shumçës),
Gjysmëproporcional,
Proporcional.

Brenda këtyre të trijave, kemi 10 “nënfamilje»:

I pari fiton postin (PFP)
Votimi në bllok (VB),
Vota alternative (VA),
Sistemi me dy turne (SDT), të gjitha janë sisteme të shumicës-mazhorancës.
Sistemet paralele,
Vota e kufizuar (VK)
Vota e vetme e patransferueshme (VVPT) janë sisteme gjysmëproporcionale.
Me lista PR,
Proporcionale me anëtarë të përzierë (PAP),
Vota e vetme e transferueshme (VVT), të gjitha janë sistemet proporcionale.

Mënyra më e rëndomtë për t'i shikuar sistemet elektorale është grupimi i tyre sipas saktësisë që votat kombëtare të fituara paraqesin vendet e fituara në parlament; do të thotë, se janë proporcionale. Për të bërë këtë, duhet parë si raporti midis votës dhe vendit ashtu edhe nivelin e votave të humbura. Për shembull, Afrika Jugore ka përdorur një sistem elektoral proporcional klasik për zgjedhjet e veta të para demokratike në vitin 1994, kurse me 62.65% të votave të popullit Kongresi Kombëtar Afrikan (KKA) ka fituar 63% të vendeve kombëtare. Sistemi elektoral ishte shumë proporcional, kurse numri i votave të humbura (d.m.th. ato që ishin hedhur për partitë të cilat nuk kishin fituar vende në asamble) ishin gjithsej vetëm 0.8%. Kontrasti i drejtpërdrejtë nga viti paraprak, në kombin fqinjë të Lesoto-së, shumica sistemit elektoral klasik i pari fiton postin (PFP) kishte dalur në Partinë e Kongresit të Basoto-së, duke fituar çdo vend të parlamentit prej 65 anëtarësh me 75% të votave të popullit; nuk kishte kurrfarë opozite parlamentare, kurse 25% të zgjedhësve që kishin votuar për partitë e tjera nuk u përfaqësuan fare. Ky rezultat u pasqyrua në zgjedhjet me votim në bllok në Xhibuti në vitin 1992, kur të gjitha 65 vendet parlamentare i kishte fituar Rassemblement Populaire pour le Progres me 75% të votave.

Mirëpo, në disa rrethana, sistemet elektorale joproporcionale (siç është PFP) mundën rastësisht të ngrisin rezultatet e përgjithshme relativisht proporcionale. Ky rast ishte në vendin e tretë të Afrikës Jugore, Malavi, në vitin 1994. Në ato zgjedhje, partia prijëse, Fronti Demokratik i Bashkuar fitoi 48% nga vendet me 46% të votave, Partia e Kongresit të Malavisë fitoi 32% të vendeve me 34% të votave, kurse Aleanca për Demokraci fitoi 20% të vendeve me 19% të votave. Niveli i përgjithshëm i proporcionalitetit ishte i lartë, por për shkak të faktit se ky nuk ishte krejtësisht një sistem proporcional, nuk mundi të kategorizohet si i tillë, votat e humbura megjithatë u shtuan deri në thuaja një të katërtën e të gjitha votave të hedhura.

Përfundim

Njëra prej çështjeve më fundamentale që parashtrohet në teorinë e psefologjisë dhe të shkencave politike, është sqarimi i rolit të sistemeve zgjedhore për konsolidimin e demokracisë përfaqësuese. Në përgjithësi, sistemet zgjedhore luajnë rol shumë të rëndësishëm për konsolidimin e demokracisë përfaqësuese, mirëpo secili prej tyre ka rol pozitiv nëse aplikohet mbi bazën e specifikave të natyrës politike, ekonomike, të ndasive etnike dhe natyrisht edhe në bazë të traditës për ndërtimin e shtetit të së drejtës. Shtetet me demokraci të konsoliduar në radhë të parë dizajnojnë sistemin zgjedhor i cili hartohet nga një ekip ekspertësh dhe ju përshtatët interesave të përgjithshme shoqërore. Organizimi i zgjedhjeve bëhet mbi bazën e një varg aktesh juridike që sanksionojnë zgjedhjet duke marrë për bazë standardet më të avansuara ndërkombëtare për zgjedhje demokratike.

Pra, çdo demokraci e re duhet të përzgjedhë (ose të trashëgojë) një sistem zgjedhor për të zgjedhur parlamentin e vet, por vendimet e tilla shpesh ndikohen nga një ose dy rrethana vijuese: faktorit politik i mungon njohuria dhe informimi themelor, kështu që zgjedhjet dhe pasojat e sistemeve të ndryshme zgjedhore pranojnë plotësisht, ose përkundrazi, aktorët politikë shfrytëzojnë njohuritë e tyre mbi sistemet elektorale për të avancuar format që ata mendojnë se do të kishin sukses për avantazhin e tyre të njëanshëm.

Sistemi elektoral, përcakton rezultatit e zgjedhjeve, në mënyrë paraprake. Ky ligj, i cili vendoset në bashkëpunim me partitë e mëdha politike dhe që përcaktohet në Kushtetutën e vendit, ka rëndësi shumë të madhe për të ardhmen katër vjeçare të vendit. Një sistem mund të favorizojë ose jo një parti ose një grup social, në varësi të votave të cilat ata arrijnë të fitojnë dhe kjo përkthehet në mandate politike në Parlament

Në bazë të analizave dhe studimeve të shumta, mund të arrij në përfundim se për vendin tonë sistemi i cili është më i përshtatshëm është sistemi mazhoritar. Një sistem antik i cili favorizon stabilitetin qeverisës. Që krijon një mazhorancë dhe një opozitë, por nuk kemi një tablo të saktë të përfaqësimit të votës. Mendoj, se e domosdoshme për të ardhmen politike të vendit tonë, është shumë e nevojshme stabiliteti qeverisës dhe e theksoj se për realitetin shqiptar, ky lloj sistemi mund të jetë efektiv dhe i dobishëm.

Bibliografia

- Beetham, D. & Boyle K. "80 pyetja dhe pergjigje", Botim i Dita, Tiranë, 2001, fq. 62.
- Biberaj Elez, 2011, "Shqipëria në tranzicion, Rruga e vështirë drejt demokracisë 1990-2010", Instituti i studimeve Ndërkombëtare, Botimi i dytë i plotësuar.
- Bingham Powell, Contemporary Democracies: Participation, Stability and Violence, Cambridge, Mass, Harvard University Press, 1982.
- Bufi B. (2010), "Tempulli i demokracisë, OMBRA GVG, Tiranë.
- Dahl A. Robert. (1971), "Poliarkia", New Haven & London, Yale University Press, 1-32.
- Dahl A. Robert. (2000), "On democracy", Aspekt Pres, Moskva.
- Feraj H. (2007), "Shkenca Politike", Një hyrje, Pegi, Tiranë.
- Godo S. "Disa konsiderata të përgjithshme".
- Hague Rod and Harrop Martin, Comperative Government and Politics (Confronta governativa e politica), 6th-Edition, Basingstoke, Macmillan, 1987.
- Heywood A. (2008), Politika, ISPL, Dudaj.
- J. Linz, A. Stepan Problems of Democratic Transition and Consolidation, 1996.
- Linz Juan and Alfred Stepan, "Democratic Ttransitions and Democratik Consolidation: Southern Europe, South America, and Post-Communist Europe", Mimeo, 1991.
- Liçi, I. "Rruga e vetme drejt demokracisë", Shtëpia botuese Marin Barleti, Tiranë, 2007, fq.
- 1 Marku, Mark, "Pjesëmarrja në demokraci një ABC", fq 64.
- Morlino Leonardo, "Democratic Consolidation, Oxford University Press, 1998.
- Miller M. (1 Korrik 2011), "The Poor Man's Capitalist," New York Times Magazine.
- Niemi G. dhe Hepburn A. (Winter, 1995), "The Rebirth of Political Socialization", Prespektives on Political Sience 24.
- Pëllumbi Servet, "Demokracia dhe zëri i moralit", Instituti i Sociologjisë, 2008.
- Pirrdham Geoffrey, "Securing Democracy Political Parties and Democratic Consolidation in Southern Europe", Routledge, Neë York, 2003.
- Rustow, Dankward, "Transitions to Democracy Towards a Dynamic Model", Columbia University Press, 1970.
- Sartori, G. (1993), "Edhe një herë për teorinë e demokracisë", Pjesa e Parë: Debati bashkëkohor, përkthyer nga Pavli Qesku, Dituria, Kapitujt 2, 5, 6 & 7.
- Shively W. (2010), "Hyrje në Shkenca Politike, Pushteti dhe Zgjedhja", ACFR, Tiranë.
- Schumpeter J. (1947), "Capitalism, Socialism and Democracy", UK.
- Tushi Gëzim (2006), "Politika dhe qytetari", Shtëpia Botuese "Ermal".
- Tushi Gëzim (2005), "Kriza e politikës dhe ideokracia", artikulli i botuar në Gazetën Metropol, në 7 prill 2005, Tiranë. Ulqini
- Mujo (2005), "Një anëtar, një vote në Shqipëri. Një koleksion shkrimesh politike – Në vendimmarrje dhe zgjedhjen e udhëheqësve, USAID, Pegi, Lundër, Tiranë.
- <http://www.businessdictionary.com/definition/funds.html#ixzz3XQCE0dDK>

Roli garantues i gjyqtarit për hetimet paraprake

Abstrakt:

Ky punim orvatet të përshkruajë dhe argumentojë rolin dhe rëndësinë e prezencës së gjyqtarit për hetimet paraprake ne procesin dhe sistemin e drejtësisë. Së pari do përpiqemi të përshkruajmë rolin e rëndësishëm që ushtron ky gjyqtar për procesin dhe sistemin duke e trajtuar dhe vendosur në pozitën e një organi sovran të pushtetit gjyqësor. Si organ do përpiqemi padyshim të përshkruajmë rolin garantues që ushtron një personazh i tillë për hetimet paraprake dhe pamundësinë e eliminimit të një faze që paraprin gjykimin. Përveç funksionit garantues në hetimet paraprake, do përpiqemi të argumentojmë rëndësinë e tij duke përshkruar rolin e rëndësishëm garantues dhe funksionin e tij kontrollues gjatë hetimeve paraprake.

Dokt. Andi Duraj
Universiteti European i Tiranës
andi.duraj@uet.edu.al

Është e rëndësishme shprehet Ferraioli (2006) që në fillim të konstatohet një realitet që pa asnjë hije dyshimi, paraqitet si një e dhënë e pa zëvendësueshme, sa herë që vëmendja vihet në procesin penal si një eksperiencë. Është ideja e një procesi që zhvillohet në respektim të plotë të parimeve natyrore të gjykimit dhe që mbështetet në parimet e qenësisë, shprehshmërisë dhe kontraversialitetit – që arrihet përmes një debati publik, në zhvillimin e të cilit, në pozicionet e kundërta dialektike midis palëve, gjyqtari rindërton faktin që integron elementët e një akuze për të qartësuar nëse bëhet fjalë vërtetë për një vepër penale dhe nëse për të duhet të përgjigjet subjekti të cilit i atribuohet. Dhe ky realitet nuk mund të gjejë aplikim tjetër përveçse në rastet përjashtimore.

Kodi në fuqi, pavarësisht karakterit të sistemit penal, pavarësisht sforcimeve të ligjvënësit për të mbajtur brenda fraksioneve kohore të mirë përcaktuara aktivitetin hetues të drejtuar në thellimin e përmbajtjes së *“notitia criminis”*, (njohje me faktin që përbën vepër penale) ka dashur ti bëjë ballë nevojës për të parashikuar, sidoqoftë, një fazë, të natyrës paraprake, e rezervuar për formulimin e akuzës.¹

Është e vërtetë se mund të jemi në kushtet e gjykimit të menjëhershëm siç ndodh në rastin e parashikuar në ligj kur aplikohet gjykimi i drejtpërdrejtë, që siguron një proces pothuajse kontekstual në momentin e kryerjes së aktit që përbën veprën penale. Por kjo mënyrë verifikimi vazhdon të inspirohet nga kriteret formale, zyrtare të cilat përbëjnë rastin përjashtimor të zgjedhjes.

Në shumicën e rasteve, akuza, e nënkuptuar si atribut ndaj një subjekti ose i një fakti me rëndësi penale nuk mund të fokusohet veçse në përfundim të një procesi verifikimi dhe bazueshmërie mbi *“notitia criminis”*, që në mënyrë të paevitueshme kërkon një hark kohor të përshtatshëm.

Faza ekziston dhe nuk mund të eliminohet nga logjika e verifikimit penal. Vlera që mund ti atribuohen asaj që është mbledhur, në momentin pasardhës të gjykimit, mund të bëjë mundur inkuadrimin e një procesi inkuizitor apo akuzator.

Në mënyre analoge nuk mundet të mos konceptohet prezenca e një gjyqtari në fazën paraprake, në kuptimin që do të rezultonte krejtësisht e gabuar në qoftë se prokurori do të kryente të gjitha veprimet të cilat mund të rezultojnë dhe arbitrare dhe personi nën hetim të cilit i kufizoheshin të drejtat dhe liritë themelore nuk do ti jepej mundësia të ankimonte një fakt të tillë.

1. Gjyqtari i hetimeve paraprake si organ i pushtetit gjyqësorë

Akuza, e kuptuar si atribuim ndaj një subjekti është produkt i një procesi verifikimi dhe mbështetje e *‘notitia criminis’*, e cila kërkon padyshim në raste të përgjithshme një periudhë kohe të përshtatshme

¹ Është e qartë influenca e ushtruar nga KEDNJ që i njeh çdo personi të drejtën e një procesi të rregullt ligjorë brenda një afati të arsyeshëm, si* specifikohet dhe në Paktin Ndërkombëtar për të drejtat Civile dhe Politike (Ligji nr.7510 date 8.08.1991) mund “të gjykohet pa vonesë të pa justifikuar”.

për hetimet paraprake , gjatë së cilës prania e një gjyqtari është thelbësore jo vetëm për shkak se hetimet përfundojnë duke prekur sferat e lirive të garantuara në kushtetutë, por edhe sepse vendimi i prokurorit për të mos filluar procedimin ka një karakter ligjor dhe duhet të jetë gjyqtari që vendos nevojën për një gjykim.

Ligji nr. 98\2016, datë, 06.10.2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” nuk e parashikon në mënyrë specifike gjyqtarin e hetimeve paraprake si organ i veçantë pranë gjykatës penale, gjithsesi ai ka funksion ligjor dhe ky funksion buron nga vet dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Juridiksioni, implikon dialogun midis titullarëve të interesave të kundërta për ndjekjen e fakteve penalisht të jashtëligjshme dhe për vëzhgimin e të drejtës së mbrojtjes përpara një gjyqtari, i cili nga ai dialog, duhet të nxjerrë arsyet e bindjes së tij.

Sa herë që prokurori hap hetimet për pjesëmarrjen e mbrojtjes duke u vendosur në pozicione kundërshtuese me mbajtësin e një të drejte të garantuar nga Kushtetuta, përmbushen kushtet e domosdoshme që kjo veprimtari të ketë karakter ligjor. Nëse kjo veprimtari më pas i nënshtrohet vlerësimit të një gjyqtari, garancitë ligjore kanë mënyrë që të shprehen tërësisht. Nëse jemi përpara një kërkesë drejtuar gjyqtarit pavarësisht përmbajtjes dhe palës që e parashtron ose që implikon kontradiktën dhe vendimi që do të jepet për ti dhënë përgjigje kërkesës nuk mund të mos jetë një vendim me karakter ligjor pasi gjyqtari është thërritur të “*jus dicere*”, duke ushtruar kështu një funksion që vetëm atij i përket.

2. Roli garant dhe funksioni kontrollues i gjyqtarit në hetimet paraprake

Neni 278 i Kodit të Procedurës Penale është një dispozitë e vendosur midis normave që sigurojnë hetimet paraprake dhe seancën paraprake dhe në të njëjtën kohë përpiqet të sigurojë se përgjatë hetimeve paraprake (në rastet e parashikuara në ligj mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, të dëmtuarit dhe palëve private) vendos gjykata. Duke qenë organ i legjitimuar për të vendosur mbi kërkesën e palëve, si të prokurorit ashtu dhe të palëve të prekura nga hetimet, ka një gamë të gjerë kompetencash.

Përtej fushave të lirisë personale (masa sigurie me karakter personal) dhe në përdorimin të mjeteve të kërkimit të provës (raste në të cilat paraqiten nevoja për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të cilat e bëjnë të paevitueshme prezencën e një gjyqtari) ndërhyrja e gjyqtarit të hetimeve paraprake sipas Dalia & Ferraioli (2010) lëviz në një fushë shumë të gjerë² dhe do ishte një sipërmarrje me të vërtet e vështirë të tentoj të rendisë të gjithë rastet në të cilat gjyqtari mund të thirret për tu shprehur.

² Neni 201/a Marrja me detyrim e kampionëve biologjikë ose kryetja e procedurave mjekësore të detyruar; Neni 201 Këqyrja e vendeve dhe e sendeve; Neni 202/a Vendimi për lejimin e kontrollit; Neni 208/a Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike etj.

Gjyqtari i hetimeve paraprake merr rolin e garantit pasi është subjekti i vetëm i cili mund të vendosë për lirinë personale,³ dhe përsa i përket përgjimit të komunikimeve,⁴ si në njërin rast ashtu edhe në tjetrin mund të vlerësojë masën e marrë eventualisht me urgjencë nga organet e policisë gjyqësore apo nga prokurori.

Funksioni kontrollues mbi veprimtarinë e organit të akuzës është i shmangshëm në aktivitetin që ushtron në fazën e vlerësimit, të kundërshtimit të personit nën hetim ose të viktimës kundër vendimit të prokurorit për të zgatur afatet e fiksuar për zhvillimin e hetimeve paraprake.⁵

Kompetencat që i janë dhënë gjyqtarit të hetimeve paraprake, kur thërritet nga palët e legjitimuara për të kundërshtuar vendimin e prokurorit për mos fillimin e procedimit penal mund të cilësohen si fuqi kontrolluese.⁶

Gjyqtari i hetimeve paraprake, funksionet e garancisë dhe të kontrollit mund ti vër në praktikë vetëm nëse vihet në lëvizje nga palët e interesuara. Atij mund të mos i parashtrahet asnjë kërkesë sepse mund të ndodhë që nuk është e nevojshme që gjatë hetimeve paraprake, të merren masa sigurie që kufizojnë lirinë e personit nën hetim, sepse së pari subjekti i interesuar mund të mos kundërshtojë vendimin e prokurorit për zgjatjen e hetimeve apo vendimin për mos fillimin e procedimit apo së dyti, prokurori mendon që mos të përdor mjetet e kërkimit të provës ose së treti nuk paraqitet nevoja për sigurimin e provës.⁷

Doktrina dhe jurisprudenca Italiane⁸ bën ndarjen mes gjyqtarit “për” hetimet paraprake ne rastet kur miraton kërkesën e prokurorit për lejimin e përgjimeve apo për të ushtruar kontroll banese dhe për gjyqtarin “mbi” hetimet paraprake, kur thirret të vendosi mbi ankimin e palës kundër vendimit të prokurorit për mos fillimin e procedimit sipas parashikimeve të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale i cili në këtë rast është pa diskutim gjyqtar themelor që vendos mbi hetimet sepse duhet të qartësoj dhe sigurojë nëse ekzistojnë kushtet për mos fillimin e procedimit ose duhet të thellohen hetimet duke përcaktuar drejtimin e tyre.

³ **Neni 244 Kërkesa për caktimin e masave të sigurimit.**

“Masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsyet ku bazohet kërkesa. Vendimi merret në dhomë këshillimi dhe jepet i arsyetuar”

⁴ **Neni 222 Vendimi për lejimin e përgjimit**

“Me kërkesën e prokurorit, për rastet e lejuara në paragrafin 1, të nenit 221, gjykata autorizon përgjimin me vendim të arsyetuar, kur ai është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara dhe kur në ngarkim të personit ekziston një dyshim i arsyeshëm dhe i bazuar në prova se ka kryer një vepër penale”

⁵ **Neni 325 Ankimi për zgjatjen e afatit të hetimeve**

“I pandehuri dhe viktimat kanë të drejtë, brenda dhjetë ditëve nga njoftimi, të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit kundër vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve”.

⁶ **Neni 291 Vendimi për mosfillimin e procedimit**

Pika 2 “Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit”.

⁷ **Neni 320 Disponimi mbi kërkesën për sigurimin e provës**

“Brenda dy ditëve nga ardhja e përgjigjes për marrjen e njoftimit për kërkesën për sigurimin e provës, gjykata merr vendim, me të cilin pranon ose rrëzon kërkesën për sigurimin e provës”.

⁸ Gjykatës Kushtetuese Italiane i është dashur të ndërhyjë shumë herë në kohë për të identifikuar sistemin e papajtueshmërive, duke konsoliduar pozicionin e gjyqtarit për hetimeve paraprake. I referohem vendimit nr: Corte.Cost 20 maggio 1996 nr 155, Corte.Cost 9-17 giugno 1999, nr 241.

Përfundime

Sistemi jonë i drejtësisë ndodhet në një proces tranzicioni në përpjekje serioze për të ndërtuar një model dhe sistem mbështetur në idealet e njerëzve, që përfaqëson në mënyrë të drejtë dhe denjë interesat dhe vlerëson në mënyrë serioze dhe objektive të drejtat dhe kufinj të tyre. Besoj fort që është momenti dhe kushtet e duhura për implementimin apo aderimin e formave, instrumentave apo organeve të reja të cilat në fakt do shërbenin për të arritur më mirë dhe lehtë qëllimet mbi të cilat pritet të funksionojë ky sistem. Gjyqtari për hetimet paraprake është një shembull konkret dhe serioz që padyshim duhet marrë në konsideratë.

Bibliografia:

Ferraioli, M (2006) 'Il ruolo di "grante" del giudice per le indagini preliminari', Terza edizione, Verona: Cedam.

Dalia, A., Ferraioli, M (2010) "Manuale di Diritto Processuale Penale" Settima edizione, Padova: Cedam.

Kodi i Procedurës Penale

